

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FJALORI
ENCIKLOPEDIK
I KOSOVËS

I
A-K



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

ENCYCLOPEDIA DICTIONARY OF KOSOVA

I
A-K



PRISHTINA, 2018

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

I
A-K



PRISHTINË, 2018

KRYEREDAKTOR DHE REDAKTOR PËRGJEGJËS:
Akademik Mehmet Kraja

REDAKSIA QENDRORE:

Akademik Pajazit Nushi, akademik Ali Aliu, akademik Tahir Emra,
(akademik Zeqirja Ballata), akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha,
akademik Fejzullah Krasniqi, akademik Mehmet Kraja

ISBN 978-9951-615-84-6

ISBN 978-9951-615-85-3

Copyright © Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK)

Rr. Agim Ramadani nr. 305, 10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel. +383 38 249 303; fax. +383 38 244 636

E-mail: ashak@ashak.org

PARATHËNIE

Fjalori Enciklopedik i Kosovës, vepra e parë enciklopedike e botuar në Kosovë, është hartuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), me pjesëmarrjen e një numri bashkëpunëtorësh të fushave të ndryshme të shkencës dhe të artit. Botimi i këtij Fjalori, përveç që përmbush nevojat për një shfrytëzim të gjerë nga lexues të ndryshëm, njëkohësisht krijon bazën e të dhënave për Kosovën si entitet i mëvetësishëm politik, gjeografik, ekonomik dhe kulturor, por duke mbajtur në vëmendje se Kosova është pjesë e një tërësie më të gjerë historike dhe kulturore shqiptare dhe se ndarjet në këtë drejtim, pavarësisht nëse janë të përkohshme ose të qëndrueshme, gjithnjë janë artificiale dhe të panatyrshme. Përfshirja e ndarë e Kosovës në këtë lëndë enciklopedike nuk paragjykon qëndrueshmërinë e zgjidhjeve politike, as aktuale e as të pritshme. Ndarja e Kosovës nga tërësia historike dhe kulturore shqiptare në këtë rast është bërë për arsye praktike dhe, duke anashkaluar çdo interpretim me prapavijë, synon të konsolidojë dijet për botën shqiptare dhe të plotësojë informacionin për të, kudo që ai mund të përfshihet dhe të përdoret.

Nevoja për të pasur të përmbledhur një dije enciklopedike për Kosovën është ndier shumë kohë më parë, por mundësitë institucionale për një ndërmarrje të këtillë kanë qenë të kufizuara. Për shkak të rrethanave politike dhe për shkak të dinamikës së ngjarjeve Kosova vazhdon të ketë në përdorim të dhëna të përafërta ose tërësisht të pasakta për shumë fusha. Kështu, ndërsa më një anë vlefshmëria shkencore e informatave për Kosovën është relativizuar së tepërmi, më anë tjetër rëndësia e tyre ka vazhduar të mbetet gjithnjë parësore. Mungesat në sistemimin e informacionit, shkujdesjet e shpeshta në përdorimin e tij, ndonjëherë edhe keqpërdorimet e qëllimshme, ndër të tjera, kanë shërbyer edhe si nxitje shtesë për të realizuar projektin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, si një kodifikues i mundshëm i të dhënave relevante.

Mungesa e përvojës në këtë lëmë të leksikografisë, sikundër edhe mungesa e bazës së të dhënave për fusha të ndryshme të shkencës, të artit, të kulturës dhe të dijeve të përgjithshme kanë bërë që puna rreth hartimit të këtij fjalori të kalojë nëpër vështirësi të natyrave të ndryshme, hartuese-metodologjike dhe teknike-organizative. Janë dashur më shumë se pesë vjet punë për t'i vjelë të dhënat e shpërndara nga burime të panivelizuara dhe për t'i bashkërenduar të gjitha nismat dhe përvojat individuale, për të finalizuar së fundi një vepër kolektive, duke zbatuar kritere sa më të qëndrueshme në vjeljen dhe sistemimin e lëndës, si dhe duke harmonizuar diskurse krejtësisht të ndryshme në hartimin e teksteve autoriale.

Që në fillim, për hartimin e fjalësit të zërave dhe më pas të teksteve të Fjalorit është synuar të ndiqet kriteri bazë i gjithëpërfshirjes. Hartimi i një fjalësi të plotë dhe të qëndrueshëm

ka qenë orientimi kryesor i të gjitha strukturave redaktoriale të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Mbështetje kryesore e kriterit të përfshirjes së lëndës enciklopedike është synuar të jetë vlera shkencore e informacionit që ofron secili zë për secilën fushë veç e veç, duke bërë përpjekje që këto vlera të harmonizohen brenda fushës dhe në raport me fushat e tjera, në mënyrë që të mos paraqiten shpërputhje ndërmjet zërave të të njëjtës fushë dhe zërave të fushave të ndryshme. Gjithashtu, në hartimin e fjalësit të zërave dhe më pas të teksteve të Fjalorit është synuar që kriter themelor të jetë objektiviteti. Është bërë përpjekje që asnjë njësi e përgjithshme ose e përveçme mos të përfshihet në Fjalor ose të mbetet e papërfshirë për shkaqe subjektive.

Në këtë version të Fjalorit Enciklopedik, sikundër mund të vihet re, Kosova është përfshirë në tërësinë e saj, si entitet politik, gjeografik, historik, ekonomik, arsimor dhe kulturor. Më anë tjetër, duke qenë se shqiptarët e Luginës së Preshevës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi kanë funksionuar për një kohë të gjatë me lidhje të ngushta me Kosovën, është parë e arsyeshme që përfshirja e tyre në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës të bëhet në mënyrë të diferencuar: Lugina e Preshevës është marrë në trajtim në tërësinë e saj, ndërsa entitetet shqiptare të Maqedonisë dhe të Malit të Zi janë përfshirë si tërësi historike dhe kulturore, ndërsa nuk kanë marrë trajtim të veçantë gjeografik, politik dhe ekonomik.

Në punët redaktoriale dhe autoriale të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës u angazhua numër i madh bashkëpunëtorësh, anëtarë të ASHAK-ut, profesorë të Universitetit të Prishtinës dhe bashkëpunëtorë shkencorë të instituteve, gazetarë dhe publicistë, shkrimtarë dhe krijues të artit të fushave të ndryshme. Për hartimin e rreth 6,000 zërave ishin të angazhuar 72 bashkëpunëtorë, që të gjithë profesionistë të shquar të lëmenjve përkatës të shkencës, të artit dhe të kulturës, të ndarë në 24 redaksi. Ata, bashkë me Redaksinë Qendrore, ishin bartësit kryesorë të të gjitha fazave të punës për hartimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, përfshirë këtu edhe 506 autorët e teksteve, kontributi i të cilëve gjithashtu ka qenë shumë i rëndësishëm. Gatishmëria e të gjithëve për të bashkëpunuar në këtë projekt është për t'u vlerësuar dhe inkurajuese për ndërmarrje të tjera të kësaj natyre.

Metodologjia e hartimit të zërave dhe të njëjve të Fjalorit është mbështetur te modelet e përgjithshme të fjalorëve të ngjashëm, duke bërë disa përshtatje praktike dhe lehtësuese për lexuesit e tij. Këto përshtatje vihen re sidomos te shkurtesat, të cilat nuk kanë marrë përdorim të përgjithshëm për tërë Fjalorin, por kanë gjetur zbatim vetëm në tekstin e një zëri, duke dhënë po aty edhe shpjegimin përkatës. Disa shkurtesa të cilat tashmë kanë marrë veçoritë e emërtimeve në Kosovë, si NATO, KFOR, UNMIK, OSBE etj. në Fjalor kanë ruajtur trajtën origjinale dhe nuk janë zberthyer me rastin e çdo përdorimi. Përshtatje janë bërë edhe në përdorimin e referencës orientuese (shih), e cila për arsye praktike nuk ka gjetur vend aq shpesh në këtë botim të Fjalorit.

Në të ardhmen mbetet kompetencë e ASHAK-ut mbajtja dhe funksionimi i një redaksie të përhershme të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, qoftë për të ruajtur vazhdimësinë e punës enciklopedike në Kosovë, qoftë për të bërë korrigjimet dhe përditësimet e nevojshme, për botimet dhe ribotimet eventuale të kësaj vepre.

KËSHILLI BASHKËRENDUES:

Akademik Idriz Ajeti, akademik Mark Krasniqi, akademik Minir Dushi,
akademik Besim Bokshi, akademik Feriz Krasniqi, akademik Nexhat Daci,
akademik Engjëll Berisha

BORDI:

Akademik Hivzi Islami, akademik Isuf Krasniqi, akademik Rexhep Ismajli,
akademik Esat Stavileci, akademik Latif Susuri, akademik Rexhep Ferri

REDAKSIA QENDRORE:

Akademik Pajazit Nushi, akademik Ali Aliu, akademik Tahir Emra (akademik Zeqirja Ballata), akademik Rexhep Ismajli, akademik Eqrem Basha, akademik Fejzullah Krasniqi, akademik Mehmet Kraja (kryeredaktor), sekretare e redaksisë: Lendita Juniku Pula

REDAKSITË E FUSHAVE:

REDAKSIA E GJEOGRAFISË FIZIKE:

Dr. Ruzhdi Pllana (redaktor), dr. Vahdet Pruthi, dr. Valbon Bytyçi;

REDAKSIA E GJEOGRAFISË SOCIALE:

Dr. Ibrahim Ramadani (redaktor), dr. Gani Gashi, dr. Arsim Ejupi;

REDAKSIA E ARKEOLOGJISË DHE KOHËS SË LASHTË:

Dr. Edi Shukriu (redaktore), dr. Exhlale Dobruna-Salihu, dr. Arben Hajdari;

REDAKSIA E HISTORISË SË MESJETËS DHE PERIU DHËS BIZANTINE:

Dr. Jahja Drançolli (redaktor), dr. Muhamet Mala, dr. Qerim Dalipi;

REDAKSIA E PERIU DHËS OSMANE DHE KULTURËS ORIENTALE:

Dr. Gazmend Rizaj (redaktor), dr. Nehat Krasniqi, dr. Sadik Mehmeti;

REDAKSIA E HISTORISË SË SHEK. XIX:

Akademik Jusuf Bajraktari (redaktor), dr. Frashër Demaj, dr. Isa Bicaj;

REDAKSIA E HISTORISË SË SHEK. XX:

Dr. Fehmi Rexhepi (redaktor), dr. Sulltane Ukaj, dr. Izber Hoti;

REDAKSIA E LUFTËS SË VITEVE 1998-1999:

Sylë Ukshini (redaktor), dr. Sabit Ukaj, mr. Ruzhdi Jashari;

REDAKSIA E FUSHËS POLITIKE-JURIDIKE:

Dr. Blerim Reka (redaktor), dr. Osman Ismajli, mr. Ilir Dugolli;

REDAKSIA E EKONOMISË:

Dr. Muhamet Mustafa (redaktor), dr. Selman Selmanaj, dr. Petrit Gashi;

REDAKSIA E ARSIMIT:

Dr. Harullah Koliqi (redaktor), dr. Afërdita Deva-Zuna, dr. Islam Krasniqi;

REDAKSIA E MJEKËSISË:

Dr. Isuf Dedushaj (redaktor), dr. Avdyl Krasniqi, dr. Ismajl Dreshaj;

REDAKSIA E ALBANOLOGJISË:

Dr. Bardh Rugova (redaktor), dr. Lindita Tahiri, mr. Shpëtim Elezi;

REDAKSIA E SHKENCAVE TË NATYRËS:

Akademik Latif Susuri (redaktor), dr. Ramadan (Agim) Zajmi, dr. Behxhet Mustafa;

REDAKSIA E SHKENCAVE SOCIALE:

Akademik Anton Berisha (redaktor), dr. Nita Luci, mr. Kristë Shtufi;

REDAKSIA E SHKENCAVE TEKNIKE:

Akademik Minir Dushi (redaktor), akademik Isuf Krasniqi, akademik Fejzullah Krasniqi;

REDAKSIA E LETËRSISË:

Akademik Sabri Hamiti (redaktor), akademik Ali Aliu, akademik Eqrem Basha;

REDAKSIA E ARTIT MUZIKOR:

Akademik Zeqirja Ballata (redaktor), akademik Engjëll Berisha, mr. Arnisa Rexhepi;

REDAKSIA E ARTEVE PAMORE:

Akademik Tahir Emra (redaktor), akademik Rexhep Ferri, dr. Hivzi Muharremi;

REDAKSIA E ARTEVE SKENIKE DHE FILMIT:

Fadil Hysaj (redaktor), dr. Besim Rexhaj, Bekim Lumi;

REDAKSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE:

Dr. Fejz Drançolli (redaktor), dr. Shpresa Siqeca, dr. Sadri Fetiu.

REDAKSIA E INFORMIMIT:

Dr. Ibrahim Berisha (redaktor), dr. Milazim Krasniqi, dr. Rrahman Paçarizi;

REDAKSIA E RELIGJIONIT:

Dr. Qemal Morina (redaktor), mr. Kristë Shtufi, Nexhat Ibrahim;

REDAKSIA E SPORTIT:

Khavit Kajtazi (redaktor), Gani Kosumi, Baki Berisha;

A

ABATI I DIOKLESË (1100?-gjysma e dytë e shek. XII). Kronist anonim. Ndonjë studiues e identifikon atë me emrin Gërgur, argjipeshkëv i Tivarit dhe i Dioklesë, ndonjë tjetër si benedikt, ndonjë i tretë vetëm si prift. Në historiografi njihet me emrin Abati i Dioklesë. Disa autorë e konsideruan me origjinë romane, të tjerë me origjinë sllave, por ekziston mundësia të ketë qenë me origjinë arbërore. Supozohet se ky klerik kishte shkruar “Kronikën” e tij midis viteve 1150-1180. Emërtimi “kronikë” nuk përputhet me përmbajtjen, sepse në të nuk përmenden vitet. Autori anonim thekson se veprën e tij, që e emërton “Mbretëria e Sllavëve” (*Sclavorum Regnum*), e përktheu nga sllavishtja në latinisht, duke shkruar atë që kishte lexuar ose dëgjuar nga të moshuarit. Vepra është kompilim i shumë burimeve historike. Teksti latin është ruajtur përmes një përshkrimi të shek. XVII, publikuar në Kroaci. Kronika u botua edhe në italisht, po në Kroaci. Autori përshkruan pushtimin e Dalmacisë dhe të Prevalit nga gotët (fondi i shek. V- fillimi i shek. VI), ardhjen e bullgarëve, ardhjen në pushtet të dinastisë sunduese në Diokle, por duke mos e lidhur atë me ngjarjet historike. Në fillimet e kësaj dinastie përmendet një sundimtar me emrin Kocipar, për të cilin ballkanologu K. Jireček mendon se ishte me prejardhje arbërore. Kronika është burim i rëndësishëm historik jo vetëm për dinastinë e Dioklesë nga fillimet e saj legjendare deri në gjysmën e shek. XII, por edhe për territore, të cilat gjatë shek. XI-XII ishin të banuara nga shqiptarët, përfshirë edhe Kosovën e sotme. (Qerim Dalipi)

ABAZI Alajdin (1942-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor, akademik. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollën e mesme, ndërsa studimet



ALAJDIN ABAZI

i mbaroi në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1965). Në fillim punoi si inxhinier në Tetovë në ndërmarrjet prodhuese. Më 1969 kaloi në Prishtinë, në Fakultetin Teknik, ku ka mbajtur mësim nga lëndët teknologjia e materialeve elektroteknike dhe elektromagnetika. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa për specializim qëndroi në Universitetin e Uellsit Verior, në Britani të Madhe (1974). Disertacionin e mbrojti gjithashtu në Zagreb (1977). Gradën e profesorit ordinar nga lënda e elektromagnetikës e mori më 1985 në Universitetin e Prishtinës (UP). Qëndroi si hulumtues shkencor dhe profesor vizitor në shumë universitete dhe institucione shkencore në Amerikë dhe Europë. Në vitet 1979-1981 ishte dekan i Fakultetit Teknik të UP-së dhe drejtor i Institutin “Inkos” të Elektroekonomisë së Kosovës (1982-1990). Në periudhën 2001-2010 ishte rektor i Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë. Fushë kryesore e studimeve të tij janë teoria e fushave elektromagnetike, materialet dielektrike, energjia dhe mjedisi etj. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe i disa teksteve universitare dhe për shkollën të mesme teknike, nga të cilët veçohet teksti universitar “Materialet elektroteknike” (1982). Mori pjesë në disa projekte shkencore hulumtuese në Kosovë, Maqedoni dhe në vende të tjera. A. Abazi është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë (2006) dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Është bartës i shumë çmimeve dhe i mirënjohjeve. (Isuf Krasniqi).

ABAZI Besim (1968-). Gazetar. Lindi në Prapashiticë të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen dhe studimet për letërsi e gjuhë shqipe në Prishtinë. Në vitin 1989 filloi punën si gazetar në Radio Prishtinë, më pas vazhdoi të punojë si korrespondent i disa medieve të huaja. Në periudhën 1994-1999 ishte korrespondent nga Prishtina i Radios BBC, emisioni në gjuhën shqipe. Në vitin 1999 filloi punën si korrespondent i Radios “Zëri i Amerikës”, po nga Prishtina. Ndërkohë, punoi dy vjet në të përditshmen “Koha ditore” (1997-1999) si dhe bashkëpunoi me një varg mediesh vendore e ndërkombëtare. Vazhdon të jetë korrespondent i “Zërit të Amerikës” për radio dhe TV. (Rrahman Paçarizi)

ABAZI Hajdin (1959-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i njohur me emrin e luftës Lum Haxhiu. Lindi në fshatin Gadish të Gjilanit. Nisi studimet për filozofi në Prishtinë (1985) dhe i vazhdoi në Lund (Suedi), ndërsa u doktorua në Universitetin e Tiranës. Veprimtarinë politike e nis që në vitin 1973 në Ferizaj, për çka u arrestua dhe u dënua me 4 vjet burg (1979). Në vitin 1986 emigroi jashtë vendit, fillimisht në Zvicër dhe më pas në Suedi. Në mars të vitit 1998 u kthye në Kosovë dhe iu bashkëngjiti radhëve të UÇK-së. Më 24 qershor 1998, në cilësinë e eprorit për informim të nënshtabit të UÇK-së për Junik e Rekë, takoi në Junik emisarën e presidentit amerikan Bill Klinton, ambasadorin Riçard Hollbruk, që ishte takimi i parë diplomatik publik i UÇK-së me diplomatët e SHBA-së. Nga prilli i vitit 1999 deri në fund të luftës ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në sektorin e informim publik. Pas luftës kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e Kosovës. Në legjislaturën e parë dhe të tretë u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. Ka botuar një sërë veprash letrare dhe publicistike: “Të paepur” (1993), “Shprishja e territ” (1997), “Shqyrtime të racionalizimit në epistemologji” (2014) etj. (Ruzhdi Jashari)

ABAZI Ismet (1951-). Atlet. Kampion i shumëfishtë i vrapimeve në 400, 800 dhe 1500 metra. Gjatë periudhës 1981-1985 u bë anëtar i klubit të atletikës “Cërvena Zvezda” të Beogradit. Më 11 qershor të vitit 1975 doli fitues i vrapimit në 1500 metra me kohë 3:41.6 minuta, në garën e vlefshme për Kupën e ish-Jugosllavisë. Më 19

shtator të po këtij viti ishte në grupin final të garës në 800 metra që u mbajt në Cele të Sllovenisë. Këtë largësi e vrapoi për 1:49.80 minuta. Në vitin 1980 ishte fitues i “Krosit të bardhë”, që u mbajt në Beograd. (Ejup Llluminca)

ABAZI Nexhat (1948-2009). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kolibar, komuna e Zajazit (rrethi i Kërçovës), Maqedoni. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën normale në Shkup (1967), ndërsa studimet në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës (1973). Studimet pasuniversitare i kreu në degën e historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë (1985). Doktoroi në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës (1995). Fillimisht punoi si mësues, pastaj këshilltar pedagogjik në Gostivar, si dhe profesor në Fakultetin Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, dekan në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës dhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit Shtetëror të Tetovës. U mor me trajtimin e problemeve teorike dhe praktike të pedagogjisë, të didaktikës, të pedagogjisë parashkollore, sidomos me historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar. Përveç punimeve të publikuara në revista të ndryshme, është edhe autor i veprave “Zhvillimi i arsimit, shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912)”, “Sali Lisi” (monografi), “Poezia didaktike e Josif Bagerit” etj. (Fadbi Osmani)

ABAZI Refet (1964-). Aktor, dramaturg, shkrimtar, mësimdhënës universitar. Lindi në Tetovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për aktrim në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup (1989). Në periudhën 1989-2000 ishte aktor i ansambllit të Teatrit të Kombësive (Drama Shqipe), përkatësisht në Teatrin Shqiptar të Shkupit. Luajti shumë role në shfaqjet e ndryshme të vendosura në skenat



REFET ABAZI

e teatrove në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri etj. Nga rolet e tij, kryesisht kryesore, veçohen në shfaqjet: “Teatri obskur”, “Pranvera e librave”, “Furka e mistershme”, “Baal”, “Dielli perëndon”, “Mbreti Lir”, “Vdekja e Dantonit”, “Eshtrat që

vijnë vonë”, “Dervishi dhe vdekja”, “Kopshtthi i vishnjeve”, “Rikradi III”, “Nesër nisemi për në parajsë”, “Platonovi”, “Arka sllovene”, “Djajtë”, “Roberto Xuko”, “Matësi i tokës” etj. Luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë: “Falja e gjakut”, “Projekti Berlin”, si dhe në disa seriale televizive. U nderua me çmime të ndryshme: çmimi për aktorin më të mirë në Festivalin e Teatros së Maqedonisë “Vojdan Çernodrinski”, çmimi për aktorin më të mirë në Festivalin “Talia e flakës” në Gjilan, çmimi për aktorin më të mirë në Festivalin e Teatrit Shqiptar në Dibër etj. Është autor i disa dramave: “Akuariumi”, “Heshtja”, “Darka e thërrimeve”, “Jetë me qira”, “Ikja” etj. dhe i romaneve “I kujt ishte Joni” dhe “Duke kërkuar dritën”. Nga viti 2000 punon si mësimdhënës i lëndës së aktrimit (për mësim në gjuhën shqipe) në Fakultetin e Artit Dramatik në Universitetin e Shkupit. (Kushtrim Bektashi)

ABDULI Agron (1971-). Piktor. Lindi në fshatin Xhepçisht të Tetovës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Tetovë, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Figura dominuese e krijimtarisë së tij artistike është portreti, me shprehje abstrakte, e në trajtë ekspresive, me një kolorit të sfocuar. Ekspozitat personale i ka realizuar në galeritë e Tetovës, Shkupit, Gjilanit, pastaj në Paris, në “Cité Internationale des Arts”. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë dhe merr pjesë në shumë aktivitete të saj. Nga viti 2006 është mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. (Jëldeze Asani)

ABDULI Senad (1971-). Aktor, regjisor, mësimdhënës universitar. Lindi në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në Bogovinë, ndërkaq të mesmen në Tetovë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Luajti në shfaqje të ndryshme në teatrot shqiptare në Maqedoni dhe në Kosovë, nga të cilat veçohen: “Me dyer të mbyllura”, “Karvani i bubrrecave”, “Policët”, “Shërbëtori i dy zotërinjve” etj. Luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër. Si regjisor dhe producent realizoi disa shfaqje teatrore dhe disa filma artistikë e dokumentarë. Nga viti 1995 punon si mësimdhënës në Universitetin

e Tetovës, ku kreu edhe detyra dhe funksione drejtuese, si dekan i Fakultetit të Arteve (2000-2002) etj. Me filmin “Kohë e bukur për të vdekur” (2012) fitoi Çmimin “Aco Aleksov” për filmbërësin më të mirë në Festivalin ndërkombëtar të filmit të shkurtër “Asterfest” (2014) në Strumicë (Maqedoni). (Kushtrim Bektashi)

ABDULLAHU Adriana (1976-1999). Aktore. Lindi në Shkup. Në Ferizaj mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. U diplomua në vitin 1998 me shfaqjen “Mbreti Ibish” në regji të Faruk Begollit, në Teatrin “Dodona”. Luajti edhe në shfaqjet: “Shtatë ngjyra lamtumirë” (1995), “Maturantët” (1997), “Stjuar-desat” (1998), gjithash tu në Teatrin “Dodona”,



ABDULLAHU
ADRIANA

si dhe “Ushtari mburracak”, produksion i Teatrit Kombëtar të Kosovës (1999). U vra në Prishtinë, më 22 mars 1999, nga vrasës të panjohur. Që nga viti 1999 Teatri i Qytetit të Ferizajt mban emrin e saj, ndërsa Teatri “Dodona” ka themeluar Çmimin “Adriana” që e ndan për çdo vit për aktoren më të mirë, në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Studentëve “Skena UP”. (Arian Krasniqi)

ABDULLAHU Rexhep (1930-2007). Politikan, ekonomist. Lindi në Prishtinë. Në vendlindje kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Regjistroi Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, të cilin e ndërpreu pas një viti e gjysmë, ndërkaq më vonë studioi për ekonomi në Universitetin e Prishtinës ku edhe u diplomua. Që nga gjimnazi përfshihet në radhët e Lëvizjes Nationale Demokratike Shqiptare (1948), për çka më vonë burgoset (1956) dhe dënohet me gjashtë vjet burg. Pas daljes nga burgu, një kohë punoi si kontabilist në ndërmarrjen “Gërmia”, më vonë në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës. Në vitin 1992 themeloi Partinë e NDSH-së (PNDSH), në krye të së cilës qëndroi deri në fund të jetës. Pas vdekjes u botua libri i tij “Për bashkim, jeta-burgu-Prishtina ime, memoare”. (Nerxhivane G. Dauti)

ABDULLAHU - ZYMBERI Hanumshahe (1962-1999). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmore. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1981 mori pjesë aktivisht në demonstratat studentore. Veprimtarinë politike ilegale e vazhdoi në radhët e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Në fillim të viteve '90 u përfshi në lëvizjen për pajtimin e gjaqeve. Ishte ndër luftëtarët e para të UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut. U bë anëtare e shtabit të zonës dhe përgjegjëse për informim të brendshëm dhe informim publik. Më 15 prill 1999, në Malësinë e Zhegocit, forcat serbe ndërmorën një sulm nga të gjitha anët. Ndër dëshmorët e parë të Betejës së Zhegocit ra H. Abdullahu, së bashku me bashkëshortin e saj, Tefik Zymerin. (Shemsi Sylja)

ABDYLI Ramiz (1928-1996). Inxhinier, ushtarak, profesor universiteti, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Pejë, ku filloi



RAMIZ ABDYLI

gjimnazin dhe më pas kreu Shkollën Normale në Prishtinë (1944). Akademinë ushtarake e kreu në Beograd (1947), ndërsa studimet e larta për inxhinieri mekanike në Universitetin e Zagrebit (1962). Studimet pasuniversitare nga lëmi i mekanikës i kreu në Fakultetin e Makinerisë në Zagreb, ku mbrojti edhe disertacionin (1977). U zgjodh docent në Akademinë Teknike Ushtarake në Zagreb, më pas profesor inordinar dhe profesor ordinar (1983). Po atë vit u zgjodh anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. Më 1980 merr gradën e gjeneralmajorit dhe më 1990 gradohet gjeneralkolonel. Bëri specializime në disa akademi ushtarake në Europë dhe në Amerikë. Në periudhën 1975-1980 ishte komandant i Akademisë Teknike Ushtarake në Zagreb dhe për një kohë ishte ndihmëssekretar Federativ i Mbrojtjes së Jugosllavisë për çështje shkencore. Në vitin 1985 mbajti një cikël ligjëratash në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. R. Abdylj publikoi një sërë punimesh shkencore nga lëmi i automatikës dhe i servosistemeve hidraulike në revista shkencore

në Kroaci dhe jashtë saj dhe është autor e përkthyes i teksteve mësimore për studentët e akademive ushtarake. Përveç punës shkencore dhe profesionale, mori pjesë në themelimin e Bashkësisë Shqiptare në Kroaci, ishte i pranishëm në aktivitetet e saj dhe ndihmoi në themelimin e shkollës së mesme me mësim plotësues në gjuhën shqipe në Zagreb. Ishte bartës i shumë çmimeve, mirënjohjeve dhe dekoratave. (Isuf Krasniqi).

ABDYLI Ramiz (1944-). Historian, profesor universiteti. Lindi në Llojan të Kumanovës. Kreu historinë në Universitetin e Shkupit (1968), ndërsa studimet pasuniversitare i kreu



RAMIZ ABDYLI

në Universitetin e Prishtinës, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit (1982). Një kohë punoi mësues në Kumanovë dhe gazetar në gazetën "Flaka e vëllazërimit" në Shkup (1976-1978), më pas në Institutin e Historisë në Prishtinë (1978-1994), në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup (1994-1997) dhe mësimdhënës në Universitetin e Tetovës (1994-2009), ku ushtroi detyra me përgjegjësi, përfshirë edhe atë të rektorit. Ishte edhe drejtor i Institutit për Trashëgiminë Kulturore në Shkup (2009-2011). Autor i monografive dhe i librave nga fusha e historisë: "Bajram Shabani" (1975), "Gjendja dhe pozita e klasës punëtore në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore 1918-1941" (1986), "Zef Lush Marku" (1988), "Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1911,I" dhe "Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912" (2004) etj. Ishte kryeredaktor i revistës historiko-politike "Kosova" në shqip dhe anglisht (1993-2000) dhe kryeredaktor i revistës "Studime albanologjike" (Shkup, 2009-2011). Ka botuar studime, artikuj dhe trajtesa në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe një varg artikujsh publicistikë. (Fehmi Rexhepi).

ABDYLI Tahir (1942-2015). Historian. Lindi në fshatin Kërrninë të Istogut. Shkollën fillore e kreu në Rakosh, ndërsa të mesmen në Pejë. Kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik në Prishtinë më 1969. Po në këtë fakultet kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit (1978). Një kohë punoi

mësimdhënës i historisë në Rakosh të Istogut, në gjimnazin e Prishtinës deri më 1974. Deri më 1981 ishte zëvendëssekretar i Bashkësisë Krahinore të Punës Shkencore, ndërsa në periudhën 1981-1990 ishte drejtor i Institutit të Historisë, redaktor i disa monografive historike, anëtar redaksie i revistave shkencore dhe kryeredaktor i revistës “Kosova”. Derisa u pensionua (2007) punoi këshilltar shkencor në Institutin e Historisë. Është autor i veprave: “Zhvillimi i industrisë në Kosovë 1945-1978” (1978), “Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1900-1903” (1981), “Mitrovica 1945-1980” (bashkautor, 1985), “Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare dhe Demokratike Shqiptare 1908-1933” (1990), “Isa Boletini, tribun popullor” (1997). Është autor i disa teksteve shkollore. Ka botuar punime shkencore dhe ka marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Isa Bicaj)

ABETARJA E PËRBASHKËT. Abetarja kombëtare shqipe e vitit 2012, hartuar nga dr. Mimoza Gjokutaj, dr. Shezai Rrokaj, dr. Islam Krasniqi dhe Saranda Kumnova-



Pozhegu. Është rezultat i marrëveshjes midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës të vitit 2010, me synim përafrimin e sistemit të arsimit shqip në të dy vendet. Është një abetare pako, e cila përbëhet


nga: Parabetarja, e mbështetur në metodën fonetike, alfabetike dhe sintetike; Abetarja, e mbështetur në metodat analitike dhe sintetike dhe Pasabetarja, e cila përmban pjesë tekstesh të përshtatshme për nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore. Abetarja shoqërohet edhe me “Abetaren e punës”, përmes së cilës nxënësit mund të bëjnë ushtrime të ndryshme, me qëllim të përvetësimit më të mirë të përmbajtjeve në tekstin bazë. Këtu bën pjesë edhe “Teksti i mësuesit”, një udhëzues didaktik-metodik për punën e tij me abetaren. Për hartimin e kësaj abetareje u shfrytëzua tradita e mirë e abetareve shqipe, si dhe metodologjia bashkëkohore e hartimit të teksteve të tillë, përfshirë edhe metodën e të nxënës ndërvetësues, metodën dhe strategjinë e të nxënës në shkallë të ndryshme të vështirësisë dhe strategjinë e të menduarit kritik. Botues i kësaj abetareje për Shqipërinë

ishte SHB “Pegi”, ndërsa për Kosovën SHB “Dukagjini”. (Islam Krasniqi)

ABETARJA. Libri i parë shkollor për mësimin e lexim-shkrimit në gjuhën shqipe ishte abetarja e Naum Veqilharxhit (1844), pas së cilës Veqilharxhi dhe autorë të tjerë hartuan mbi 150 abetare të tjera, midis të cilave është edhe “Abetarja e Zymit” (1900). Hartimi dhe botimi i abetareve shqipe në Kosovë u intensifikua pas Luftës së Dytë Botërore. Ky proces filloi me abetaren “Këndimi im i parë” (1945) dhe vazhdoi me abetare të tjera sipas kësaj kronologjie: “Abetare për të rritun” (1946), hartuar nga Mehmet Gjevori, Sali Kolgeci, Ibrahim Riza, Rexhep Shpendi; “Abetare për klasën e parë të shkollës fillore” (1947, ribotuar më 1948, 1950), hartuar nga Mehmet Gjevori, Jani Gjino, Stathi Kostari; “Abetare për të rritun” (1948, ribotuar më 1950), hartuar nga Mehmet Gjevori, Shevqet Veliu, Stathi Kostari, Talat Paçarizi; “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” (1951, ribotuar më 1954) me autorë: Mehmet Gjevori dhe Stathi Kostari; “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” (1955, ribotuar më 1958, 1960, 1962, 1964, 1965), me autorë: Mehmet Gjevori dhe Jusuf Shushka. Nga viti 1966-1972, në shkollat fillore të Kosovës, me mësim në gjuhën shqipe, u përdor abetarja e Ramiz Hoxhës. Në abetaren e vitit 1966 shkronjat e shtypit dhe shkronjat e dorës përpunohen veçmas. Në abetaren e vitit 1967 shkronjat e shtypit dhe shkronjat e dorës përpunohen në mënyrë paralele, ndërsa në abetaren e vitit 1968 shkronjat e shtypit dhe shkronjat e dorës përpunohen veçmas. Me përpunim paralel të shkronjave ishte edhe abetarja e fundit e Ramiz Hoxhës (1969), e cila u përdor deri në vitin 1972. Në vitin 1972 u fut në përdorim “Abetare-Metoda (zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës)” e Kolë Xhumarit, Gani Bardhisë dhe Anton Lakuriqit. Pason abetarja me autor Mehmet Gjevorin, botuar më 1974 dhe abetarja e Mehmedali Hoxhës, botuar në vitin 1978 dhe ribotuar më 1979, 1980 dhe 1981. Në periudhën 1982-2007 në Kosovë u përdor abetarja e Qamil Batallit, e cila u ribotua disa herë, me pak ndryshime. Në vitin 2003 Qamil Batalli hartoi dhe botoi abetaren e re, e cila u ribotua disa herë, deri në vitin 2007. Në vitet 2008-2011 në shkollat fillore shqipe të Kosovës përdoret abetarja e Agim Devës dhe e Islam Krasniqit. Së fundi në Kosovë

është në përdorim abetarja mbarëkombëtare me autorë nga Shqipëria dhe Kosova: Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Islam Krasniqi dhe Saranda Pozhegu. (Valentina Nimonaj-Hoti)

ABRASHI Aziz (1934-2014). Aktivist sindikal, ekonomist. Lindi në Mitrovicë. Në vendlindje kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, ndërsa Fakultetin Ekonomik në Universitetin e



AZIZ ABRASHI

Beogradit. Pas studimeve punësohet në kombinatin xehetar-metalurgjik "Trepça", më vonë në Odën Ekonomike të Kosovës. Ishte sekretar Krahinor për Ekonomi (tri mandate), drejtor i përgjithshëm i kombinatit të drurit "Kosovodrvo" në Prishtinë, drejtor i përgjithshëm i kombinatit të drurit "Tefik Çanga" në Ferizaj dhe kryetar i bordit të kombinatit xehetar-metalurgjik "Trepça". Ishte pjesëmarrës i grevës së minatorëve të "Trepçës" të shkurtit të vitit 1988, me çrast u burgos nga pushteti serb. Pas daljes nga burgu sërish punoi në "Trepçë". Më 1990 u përfshi në lëvizjen sindikale, duke u zgjedhur nënkryetar i Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Për punën shumëvjeçare dhe kontributin e dhënë në proceset ekonomike dhe politike të Kosovës u dekorua me çmime dhe mirënjohje. (Osman Ismaili)

ABRASHI Jakup (1936-2011). Futbollist, trajner. Lindi në Mitrovicë, ku edhe nisi hapat e parë të futbollit në vitin 1949, si 11-vjeçar, te skuadrat e reja të "Trepçës". Në vitin 1953 debutoi me fanellën e skuadrës së seniorëve. Ishte lojtar aktiv deri në vitin 1969, kurse ka punuar edhe si mësues i kulturës fizike në gjimnazin e Mitrovicës. Gjatë karrierës si futbollist, ka qenë për një kohë të shkurtër edhe te "Rijeka", por është rikthyer te skuadra e "Trepçës". Në vitin 1965 mori drejtimin e skuadrës së "Trepçës", ndërsa suksesin më të madh si trajner e arrin kur me sukses e kualifikoi këtë skuadër në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Ai, gjithashtu, ishte aktiv edhe në futbollin e pasluftës. Për një kohë u rikthye për të punuar te skuadra e "Trepçës", pastaj drejtoi edhe klubin "Ramiz Sadiku". (Arsim Maxhera)

ABRASHI Reshat (1938-2001). Inxhinier i xehetarisë, profesor universiteti. Lindi në Mi-

trovicë, shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet e rregullta, ato pasuniversitare dhe të doktoraturës i mbaroi në Universitetin e Zagrebit. Në fillim punoi si inxhinier i xehetarisë në minierën e Stantërgut, më pas u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike të Mitrovicës (1967), më vonë docent (1980) e më pas profesor inordinar dhe profesor ordinar (1989) në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës. Fusha kryesore e veprimtarisë së tij shkencore ishte ajrimi i minierave dhe zjarret nëntokësore. Botoi disa punime në revistën "Kërkime" të ASHAK-ut dhe në revistën "Plumb-Zinku" të Institutit të "Trepçës". Në fushën e shkencave të ajrimit bashkëpunoi dhe udhëhoqi shumë tema të studimeve dhe projekteve. Është autor i tekstit universitar "Ajrimi i minierave", që është vepra e tij kryesore në këtë fushë. Mori pjesë me referate në shumë konferenca dhe simpoziume shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë ushtroi funksione drejtuese, prodekan dhe dekan në disa mandate. (Izet Zeqiri)

ABRASHI Teuta (1960-). Gjuhëtare, gjermaniste. Lindi në Kaiserslautern të Gjermanisë, ku përfundoi shkollimin e mesëm. Studimet për gjuhë dhe letërsi angleze dhe studimet pasuniversitare për gjuhësi i përfundoi në Prishtinë, ku më pas mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës. Më 2009 doktoroi në Universitetin e Prishtinës me temën "Frazat nominale në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe". Punoi si mësues i mesëm dhe gjuhës angleze, lektore e gjuhës gjermane, ligjëruese dhe nga 2010 si profesoreshë asistente në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë anëtare e redaksisë së revistës "Filologji", anëtare e këshillit të Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe nga viti 2013 anëtare e redaksisë së revistës "Studime". Është bashkëthemeluese e Shoqatës së Gjermanistëve të Europës Juglindore (SOEGV). Ka marrë pjesë në konferenca brenda e jashtë vendit, botoi studime në revista shkencore, kryesisht nga fusha e gramatikës. Ndjek studimet gjenerative dhe përpiqet t'i zbatojë ato në studimet e shqipes. Udhëheq departamentin e gjuhës dhe të letërsisë gjermane në Universitetin e Prishtinës. (Milote Sadiku)

ADAE Guillelmus (Pseudobrocardus) (1270-1341). Misionar dominikan, argjipeshkëv

i Tivarit, i cili shkroi një relacion edhe për Arbërinë. Lindi në Francën Jugore. Pasi kreu studimet, u aktivizua në urdhrin dominikan dhe shkoi në një mision në Lindjen e Mesme. Në këtë kohë Papati e kishte selinë në Avinjon të Francës (1309-1377). Shërbeu si ipeshkëv në Tabriz dhe më pas në Smirnë (Izmir) të Azisë së Vogël (1318), duke shkruar një varg relacionesh për gjendjen e katolikëve në ato vende. Së fundi ishte argjipeshkëv në Tivar (1324-1341). Nën juridiksionin e kësaj argjipeshkëvie ishin edhe trevat verilindore arbërore, Kosova dhe trevat përreth saj. Shpërthimi i kryengritjes antiserbe në Arbërinë Veriore (1332) e nxiti G. Adae t'i shkruante një relacion mbretit të Francës, Filipit VI (1332), në të cilin e njoftonte për gjendjen e rëndë të kishës katolike dhe të arbëve nën pushtimin rasian, duke kërkuar organizimin e një ekspedite ushtarake për "pushtimin e Mbretërisë së Rashës", sepse "arbrit shpeshherë prangosen, fisnikët shpronësohen dhe mbahen rob, klerikët poshtërohen e persekutohen". Ai e siguronte mbretin Filipi VI se, sapo të dukeshin forcat franceze në tokat arbërore, ky popull mund të nxjerrë 15,000 kalorës, "burra të shëndetshëm, trima e luftëtarë të mirë, të aftë për çdo betejë". Në relacion G. Adae flet edhe për traditën arsimore, kulturore dhe gjuhën mesjetare të arbërve: "Sado që arbrit kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, prapëseprapë ata kanë në përdorim në të gjitha librat e tyre shkronjat latine". (Ramiz Abdyli)

ADEMAJ Eshref (1940-1994). Matematikan, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Zhur të Prizrenit,



ESHREF ADEMAJ

shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa normalen në Prizren. Studimet për matematikë i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1964), studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1970), tezë e disertacionite mbrojtin në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1976). Punoi mësimdhënës i matematikës në disa shkolla të Prishtinës. U zgjodh asistent në Shkollën e Lartë Teknikë e më vonë në Fakultetin Teknik

të Universitetit të Prishtinës (1967-1971), më pas po në këtë fakultet e merr titullin docent, ndërsa në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (UP) zgjidhet profesor inordinar (1977) dhe profesor i ordinar (1987). Ishte nismëtar dhe themelues i studimeve pasuniversitare në departamentin e matematikës të FSHMN-së. Interesimi shkencor i tij i takon teorisë së grupeve të fundme të thjeshta, kombinatorikës dhe teorisë së bllok dizajneve. Botoi një numër punimesh shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore. Rezultatet e tij shkencore i kumtoi edhe në tubime shkencore në qendra të ndryshme studimore në Europë. Për qëllime studimore dhe hulumtuese qëndroi në Universitetin shtetëror "Lomonosov" të Moskës (1972-73) dhe në Institutin e Matematikës të Universitetit të Heidelbergut (1982-83). Mbajti ligjërata në Universitetin e Tiranës, të Sofjes, të Jenës dhe të Heidelbergut. Në vitin 1993 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kreu detyra dhe funksione të ndryshme, si dekan i FSHMN-së, prorektor i UP-së, kryetar i Shoqatës së Arsimtarëve Universitarë dhe Punëtorëve Shkencorë të Kosovës, kryeredaktor i revistës "Matematika-Fizika", kryeredaktor përgjegjës i revistës "Punime matematike" etj. U nderua me çmime dhe mirënjohje të shumta. (Qamil Hxhibeqiri)

ADEMAJ Mustafë (1936-1994). Mjek, kardiolog, primarius. Lindi në Loxhë të Pejës. Kreu shkollimin fillor në Raushiq, ndërsa gjimnazin në Pejë. Studimet për mjekësi i filloi në Shkup, i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Pas diplomimit punoi si mjek i përgjithshëm në Pejë dhe fshatrat përreth. Specializimin për mjekësi interne dhe subspecializimin për kardiologji i përfundoi në Universitetin e Zagrebit. U emërua udhëheqës i repartit të sëmundjeve të brendshme në Spitalin e Pejës. Për punën e mirë si kardiolog dhe punëtor shkencor mori titullin primarius. Më 1990 organet e dhunshme serbe e shkarkuan nga detyra. Si specialist i fushës ka merita të veçanta për kompletimin e Spitalit të Pejës me kuadër të ri mjekësor shqiptar. Pos punës si internist dhe kardiolog u mor edhe me publikime profesionale dhe shkencore. Mori pjesë në simpoziume, konferenca e kongrese dhe publikoi punime të shumta shkencore. (Binak Kastrati)

ADEMAJ Remzi (1952-1998). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Zhur të komunës së Prizrenit. Që në fillim të viteve '80 emigroi në Perëndim. Në vitin 1985, gjatë kthimit për Kosovë, u arrestua nga policia italiane dhe u dorëzua autoriteteve jugosllave. Në verën e vitit 1986, Gjykata e Qarkut të Prizrenit e dënoi me 6 vjet burg, për veprimtari politike. Më 1995 u arrestua për të dytën herë dhe u dënua me 3.5 vjet burg, me akuzë për pjesëmarrje në formimin strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës për anën e Vërrinit. Në fillim të vitit 1998 u inkuadrua në radhët e UÇK-së, në Zonën e Drenicës. Më pas, nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u emërua në detyrën e komandantit të luftës në trevën e Vërrinit. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në lagjen "Tusus", në Hoçë të Qytetit e në rrethinë të Prizrenit. Në gusht të vitit 1998 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi zëvendëskomandant për Zonën Operative të Pashtrikut. Më 14 gusht 1998, me disa bashkëluftëtarë, gjatë rrugës nga Kleçka për në Vërrin ra në pritë e forcave serbe, së pari në Tupëc, pastaj në Vlashne dhe në Grazhdanik. Më 15 gusht të vitit 1998 ra në përballje ushtarake me forcat serbe. (Bedri Muhadri)

ADEMAJ Sinan (1952-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Zhur të Prizrenit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme normale në Prizren, ndërsa studimet e larta për



SINAN ADEMAJ

ekonomi në Universitetin e Prishtinës (1976). Titullin e magjistratit të shkencave ekonomike e mori në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit (1982), ndërsa doktoroi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1991). Një kohë punoi në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, më 1977 u zgjodh asistent në Fakultetin Ekonomik, duke u ngritur në të gjitha gradat universitare. Ligjëroi në studimet baçelor, master dhe në studimet e doktoratës. Ka ligjëruar edhe në Fakultetin e Bujqësisë. Në disa universitete europiane ka qenë në vizita studimore dhe seminare për fushën e makroekonomisë. Publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale në revista të ndryshme. Është

autor i dy teksteve universitare, "Historia e mendimit ekonomik" dhe "Bazat e ekonomisë". Përveç punës pedagogjike dhe shkencore, ka kryer edhe punë menaxhuese në institucionet përkatëse të shkollimit të lartë. (Myrvete Badivuku-Pantina)

ADEMI Adem (1948-1999). Mjek, kirurg. Lindi në Ashlan, komuna e Vushtrrisë. Shkollën fillore e nisi në vendlindje, e përfundoi në Mitrovicë, ku kreu dhe shkollën e mesme. Studimet për mjekësi i filloi në Universitetin e Shkupit dhe i përfundoi në Universitetin e Zagrebit. Fillimisht punoi si mjek në Mitrovicë. Specializimin për kirurgji e përfundoi në Zagreb në vitin 1979, më 1981 u emërua kryeshf i repartit të kirurgjisë në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, ku punoi deri më 1992, kur përjashtohet nga puna nga organet e dhunshme serbe. Po atë vit hapi ordinancën e vet kirurgjike, në të cilën deri në vitin 1999 u trajtuan shumë persona të keqtrajtuar dhe të plagosur nga policia serbe. Me fillimin e luftës, A. Ademi mori detyrën e kirurgut në Zonën e Shalës, në spitalin e improvizuar ushtarak të brigadës 141 "Mehë Uka", në të cilin trajtoheshin ushtarët e Zonës së Llapit. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, mbeti në malet e komunës së Zubin Potokut, ku më 19 prill 1999 u kidnapua bashkë me 23 persona të tjerë, kryesisht intelektualë të profileve të ndryshme. Që nga ajo datë është evidentuar si i zhdukur. Krahas punës profesionale u mor edhe me publikime shkencore. (Binak Kastrati)

ADEMI Fisnik (1952-). Futbollist. Lindi në Pejë. Njihet si njëri prej futbollistëve më të mirë që ka pasur Kosova. Nisi karrierën te "Buduqnosti" i Pejës, më pas kaloi te "Trepça" e Mitrovicës (1972), ku qëndroi deri në fund të karrierës (1985). Me "Trepçën" u paraqit kryesisht në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë, ndërsa ishte pjesë e "brezit të artë" të këtij klubi, që në vitin 1977 arriti të kualifikohej në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Në edicionin 1977/78 në ligën e parë federative luajti 32 ndeshje. Pasi i dha fund karrierës si lojtar aktiv, F. Ademi nuk u mor më me futboll. Shërbeu rreth dy vjet si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës. (Arsim Maxhera)

ADEMI Habib (1970-). Basketbollist. Lindi në Kushevicë të Podujevës. E filloi karrierën

në KB “Prishtina”. Luajti edhe në Slloveni (KB “Nova Gorica”), ndërsa karrierën e vazhdoi në Francë (“Vichy”). Ka luajtur edhe në SHBA (“Indiana College”). Pos Prishtinës, në Kosovë i mbrojti edhe ngjyrat e skuadrave “Mabetex” dhe “X-Prishtina”, ndërsa gjatë karrierës së tij në Itali luajti në skuadrën “Angelico BI”. Konsiderohet njëri prej basketbollistëve më të mirë që ka pasur Kosova. (Bekim Aliu)

ADEMI Sadik (1969-). Veprimtar i lëvizjes kombëtare në Luginën e Preshevës, luftëtar. Lindi në fshatin Miratoc të komunës së Preshevës. Kreu shkollën e mesme në Preshevë, ndërsa studimet për biologji në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1990 ra në kontakt me veprimtarët e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK) dhe u përfshi në radhët e saj. Ishte bashkorganizator dhe pjesëmarrës në demonstratat e 1 dhe 2 shkurtit 1990 në Preshevë. Ishte bashkëthemelues i subjektit të parë politikë në Luginën e Preshevës, Shoqatës së Pavarur Demokratike (SHPD) më vonë Partia Demokratike Shqiptare. Gjatë vitit 1999 mori detyra të ndryshme në mbështetje të luftës në Kosovë. Në periudhën e luftës së UÇPMB-së u angazhua në Zonën Operative të Preshevës. (Fehari Ramadani)

ADEMI Xhevat (1962-). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, politikan, gazetar. Lindi në Reçicë të Madhe të Tetovës. Pas shkollës së mesme në Tetovë kreu studimet për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet për gazetari në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Që kur ishte nxënës, ishte aktiv në lëvizjen ilegale. Në shtator të vitit 1982 u arrestua dhe u dënua me 12 vjet burg. Pas daljes nga burgu (1990), u përfshi në aksionin për pajtimin e gjaqeve. Në kuvendin themelues të Shoqatës së të Burgosurve Politikë Shqiptarë në Maqedoni, që u mbajt në nëntor të vitit 1998, Xh. Ademi u zgjodh kryetar. Më 2001 u zgjodh sekretar i përgjithshëm i Partisë Demokratike Kombëtare, subjekt që doli në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 është deputet i BDI-së në Kuvendin e Maqedonisë. (Fehari Ramadani)

ADMINISTRATURA APOSTOLIKE E PRIZRENIT (Administratio Apostolica Prizriensis), shih: IPESHKVIA E KOSOVËS

ADMINISTRIMI USHTARAK NË KOSOVË (1945). Pushtet ushtarak i vendosur në Kosovë nga Jugosllavia në fund të Luftës së Dytë Botërore. Administrimi ushtarak u vendos me urdhër të komandantit suprem të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ), mareshalit Tito, më 8 shkurt 1945. Kësaj rrethane i parapriu një gjendje shumë e rëndë në Kosovë. Në fillim të janarit të atij viti udhëheqja komuniste jugosllave urdhëroi mobilizimin e “brigadave të Kosmetit” për t’i dërguar në Frontin e Sremit. Midis atyre brigadave ishte edhe ajo e Drencës, së cilës i printe Shaban Polluzha. Ajo duhej ta lëshonte Drenicën dhe të nisej në drejtim të Podujevës, për t’u bashkuar me Brigadën VII për në Serbi. Meqë shtabi i Brigadës së Drenicës e kundërshtoi largimin nga Kosova, më 25 janar nisën operacionet ushtarake në shkallë të gjerë për asgjësimin e kësaj brigade. Në operacionet kundër Shaban Pollushës morën pjesë 5 divizione të Serbisë, 2 të Maqedonisë, grupi i brigadave të Malit të Zi dhe repartet speciale të OZN-ës, të drejtuara nga Spasoje Gjakoviq. Në kohën kur forcat jugosllave zhvillonin operacionet në Drenicë, Tito jep urdhër për vendosjen e administrimit ushtarak në Kosovë. Me këtë urdhër i tërë pushteti në Kosovë i kalonte ushtarakëve, të cilët do të ushtronin pushtetin politik, ekzekutiv dhe atë gjyqësor. Me këtë rast u bë edhe ndryshimi i strukturës komanduese të Shtabit Operativ: komandat u emërua Savo Dërleviqi, duke e zëvendësuar Fadil Hoxhën, i cili mbeti zëvendës i tij, ndërsa shef i Shtabit u emëua Dushan Vukotiq-i, shef i prapavijës Stevo Dobërkoviqi, komisar politik Gjuro Medenica. Divizionet e reja të sapoformuara ndër morën aksione të gjera kundër popullsisë shqiptare, duke vrarë dhe masakruar me mijëra vetë, me pretekstin e spastrimit të vendit nga “mbeturinat e fashizmit” dhe elementët “kundërevolucionarë”. (Izber Hoti)

ADMIRALËT E PERANDORISË OSMANË ME PREJARDHJE SHQIPTARE. Në postin e admiralit të flotës osmane nga viti 1324 deri në vitin 1867, kur ky post u zëvendësua me postin e ministrit, shërbyen 161 admiralë, shumica prej të cilëve ishin me origjinë joturke. Në postin e admiralit të flotës nuk mund të arrihej pa qenë paraprakisht në postin e sanxhakbeut, bejlerbeut, apo vezirit të madh (sadrizemit). Pozitën e admiralit të flotës detare osmane

e kanë zënë një numër i konsiderueshëm shqiptarësh. Ndër të parët shqiptarë që u ngjit në këtë pozitë ishte Çavli Beu. Ai vdiq në vitin 1416, duke qenë në pozitën e admiralit. I biri i Çavli Beut, Hamza Beu, vëllai i sadriazemit të parë osman me origjinë shqiptare, Bejazit Pasha, në pozitën e admiralit erdh në prill të vitit 1453 dhe qëndroi deri në janar të vitit 1456. Ishte admiral i flotës në kohën e pushtimit të Konstandinopojës. Pastaj në këtë pozitë erdhën Kasim Beu (1459-1460), Jakup Beu (1462-1463), Zognos Mehmet Pasha (1463-1466), Gedik Ahmed Pasha (1478-1480) admiral i flotës osmane në pushtimin e Otrantos, Sinan Pashë Vlora (1491-1492), Skënder Pasha (1511-1514), Mustafa Pashë Plaku (1520-1522), Bajram Pasha (1522-152?), Ahmed Pashë Kemankesh (1531-1534), Hajredin Pashë Barbarosa (1534-1546), Ali Pashë Myezin-zade (1568-1571), Ali Pashë Gyzelxhe (1617; 1618-1619), Kemankesh Mustafa Pasha (1635-1638), Ebubekir Pasha (1644), Mehmet Pashë Çausholli (1653-1655), Kara Murad Pasha (1653-1655), Mustafa Pashë Zurnaxhiu (1655-1656), Ali Pashë Qose (1658-1660), Hysejn Pashë Qypërliu (1694-1695), Ali Pashë Nasuh-zade (1821-1822), Sylejman Rafet Pashë Qilari (1849-1851) etj. Origjina etnike e rreth 46 admiralëve osmanë ende nuk është identifikuar me saktësi. Besohet se edhe nga mesi i tyre një numër jo i vogël mund të kenë qenë me origjinë shqiptare. Admirali më i famshëm osman, që e mbajti më së gjati këtë post (mbi 12 vjet), ishte shqiptari Hajredin Pashë Barbarosa (1478-1546) nga ishulli Midilli (Lesbos). Fitorët e famshme të Barbarosës në dete, nga fitorja në Betejën e Prevezës (1538) deri te Beteja e Lepantit (1571) ia siguruan Perandorisë Osmane dominimin në Mesdhe për 33 vjet. (Gazmend Rizaj, Nehat Krasniqi)

AEROPORTI I PRISHTINËS “ADEM JASHARI”. Port ajror rreth 15 km në jugperëndim të Prishtinës. I vetmi aeroport ndërkombëtar në Republikën e Kosovës, i themeluar në vitin 1965. Fillimisht u përdor për qëllime ushtarake dhe fluturime brenda territorit të ish-Jugosllavisë. Në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar u pajis me njësinë e teknologjisë informative, sipas standardeve të ICAO-s. Gjatë viteve '90 filloi veprimtarinë e fluturimeve ndërkombëtare në një numër të vogël qytetesh evropiane, kryesisht në vendet



AEROPORTI I PRISHTINËS “ADEM JASHARI”

ku gravitonte diaspora kosovare. Pas vitit 1999 ka vepruar nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Gjatë kësaj periudhe është rinovuar dhe zgjeruar platforma dhe terminali i udhëtarëve, duke e rritur ndjeshëm numrin e udhëtarëve dhe cilësinë e shërbimeve. Në vitin 2006 Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ka marrë çmimin “Aeroporti më i mirë në kategorinë nën një milion udhëtarë” ndarë nga Këshilli Ndërkombëtar i Aeroporteve (Airports Council International). Pas pavarësimit të vendit, aeroporti është shndërruar në ndërmarrje qendrore publike, pronar i aksioneve të së cilës ishte Qeveria e Kosovës. Në vitin 2010 aeroporti i është dhënë me koncesion konsorciumit turko-francez “Limak & Airports de Lyon”. Kjo marrëveshje parasheh që aeroporti të menaxhohet nga ky konsorcium për 20 vitet e ardhshme. Gjatë kësaj periudhe operatori privat obligohet që t'i modernizojë dhe t'i zgjerojë kapacitetet e aeroportit, duke investuar mbi 100 milionë euro. Së fundi nëpër Aeroportin e Prishtinës kalojnë mbi 1,6 milionë udhëtarë në vit, duke u shndërruar në njërin ndër aeroportet më të ngarkuar në Ballkan. Në këtë aeroport operojnë një numër i konsiderueshëm i kompanive të njohura, të cilat lidhin Kosovën me shumë vende të rëndësishme të botës. (Alban Hashani)

AGAJ Ago (1897-1994). Veprimtar antikomunist. Lindi në Smokthinë të Vlorës. Mësimet fillestare i kreu në vendlindje,

ndërkaq të mesmet dhe studimet e larta i kreu në Vjenë, në fushën e agrokulturës. Mori pjesë në Kongresin e Lushnjës në vitin 1920 dhe më vonë përkrahu Revolucionin e Qershorit në krye me Fan Nolin. Në 1941, gjatë okupimit gjerman të Kosovës u caktua në detyrën e prefektit të Mitrovicës, ndërkaq më pas (1943) ishte ministër i Bujqësisë në qeverinë e Rexhep Mitrovicës. Udhëhoqi një grup të armatosur në rrethinën e Prizrenit, të cilët iu bashkëngjitën Regjimentit të Kosovës (1943-1944). Pas përfundimit të luftës, emigroi në Itali, Egjipt, Libi e më vonë në SHBA. Është autor i disa veprave me përmbajtje historike, si: “Lufta e Vlorës, Tregim i një pjesëmarrësi” (2002) dhe “Milosh Kopiliqi, Heroi i Kosovës” (2002). Ishte aktiv në emigracionin e djathtë . Vdiq në Florida të SHBA-së. (Mrika Limani)

AGAJ Refik (1927-). Gazetar, diplomat. Lindi në Hogosht të Kamenicës. Bën pjesë në mesin e gazetarëve shqiptarë të gjeneratës së parë pas Luftës së Dytë Botërore. Punën e gazetarit e filloi në vitin 1954 në “Rilindje”, në kohën kur dilte dy herë në javë. Kryesisht u mor me shkrime nga lëmi i ekonomisë, si dhe me reportazhe të lira nga viset e ndryshme të Kosovës. Një kohë u largua nga gazetaria dhe punoi në arsim, pastaj u kthye sërish në “Rilindje” në vitin 1958. Dy vjet më vonë kaloi në postin e përgjegjës për arsim dhe kulturë në rrethin e Gjilanit. Një kohë shërbeu edhe në diplomaci. (Nehat Islami)

AGANI Arta (1973-). Dizajnere. Lindi në Prishtinë. Shkollimin bazë e kreu në Prishtinë, ku kreu edhe studimet për dizajn grafik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1997). Përfundoi programin e certifikuar për dizajn dhe menaxhim të ekspozitave në Universitetin “Donau” në Krems të Austrisë. Për pesë vjet punoi si koordinatore për projekte ndërkombëtare në Galerinë e Arteve të Kosovës, ndërsa tani udhëheq një asociacion të “alumnistëve” amerikanë në Kosovë (KUSA) dhe ligjeron në një kolegji privat. Krijimtaria e saj artistike, përveç dizajnit, kohëve të fundit përfshin dhe pikturën abstrakte, e cila shquhet me një stil të veçantë ekspresiv dhe modern. Më 2004 organizoi ekspozitën personale “Femrat nga Marsi” (2004), ndërsa mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë saj. (Zeni Balazhi)

AGANI Fehmi (1932-1999). Sociolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë, ku mbaroi edhe shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Prishtinë. Mbaroi studimet



FEHMI AGANI

themelore për filozofi dhe ato pasuniversitare për shkenca politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, ndërsa disertacionin e doktoratës nga fusha e sociologjisë politike e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1973). Punoi si mësimdhënës në disa shkolla të mesme të Kosovës gjatë viteve 1950-1960, e pastaj edhe si gazetar e redaktor i politikës së jashtme në të përditshmen “Rilindja”. Më 1965 u zgjodh të ligjëronte sociologjinë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më 1967, pas rihapjes së Institutit Albanologjik, u zgjodh drejtor i tij. Në vitin shkollor 1972/73 ishte ndër themeluesit dhe shef i parë i katedrës së filozofisë dhe i sociologjisë, ligjërues i shumë lëndëve, mentor i diplomave dhe i angazhuar për mbarëvajtjen e punëve në këtë katedër. Ishte njëri ndër themeluesit e Institutit të Filozofisë dhe të Sociologjisë dhe kryeredaktor i revistave “Studia humanistica” dhe “Thema”. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe atë të dekanit të Fakultetit Filozofik. Për shkak të angazhimit politik për avancimin e statusit të Kosovës, u vu në shënjestër të diferencimit politik, veçmas pas vitit 1981, kështu që në vitin 1984 u përjashtua nga procesi mësimor. Më 1993 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa më 1996 anëtar i rregullt. Ishte njëri nga themeluesit dhe nënkryetar i LDK-së (1989-1998), si dhe anëtar i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. U pushkatua nga forcat ushtarake dhe policore serbe, afër Lipjanit, më 6 maj të vitit 1999. Puna shkencore dhe hulumtuese e F. Aganit u botua në revista të ndryshme dhe në vepra të veçanta. Pas vdekjes ajo u publikua në 8 vëllime, në një edicion të veçantë të Shtëpisë Botuese “Dukagjini” (Pejë, 2002): “Në rrjedha të mendimit sociologjik”, “Për shoqërinë civile”, “Demokracia, kombi, vetëvendosja”, “Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore” (disertacioni), “Sindikatat

gjermane dhe shkrime të tjera”, “Gjuha e dhunës dhe zëri i arsyes”, “Pavarësia, gjasa dhe shpresë”, “Intervista, reagime”. Ishte bartës i shumë dekoratave dhe i mirënjohjeve (“Urdhri i Lartë i Skënderbeut”, “Urdhri i Lidhjes së Prizrenit” dhe “Hero i Kosovës”), disa prej të cilave iu akorduan pas vdekjes. (Agim Hyseni)

AGANI Ferid (1959-). Mjek, politikan. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, si dhe Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Specializoi në lëmin e neuropsikiatrisë në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës dhe në Zagreb (1991). Në vitin 2009 mbrojti tezën e doktoraturës në UP nga fusha e psikiatrisë. Është profesor asistent në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së. Nga viti 2008 është kryetar i Partisë së Drejtësisë (PD). Ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës (2004-2007) dhe ministër i Shëndetësisë (2011-2014). Nga viti 2008 deri në 2011 ka qenë kryetar i asociacionit profesional të psikiatrisë, i njohur si “Lidhja shqiptare e psikiatrisë”. (Nerxhivane G. Dauti)

AGANI Hafiz Bajram (1899-1962). Titullar i fesë islame, veteran i arsimit. Lindi në Plavë, mësimet e para i mori në vendlindje, i vazhdoi në Shkodër dhe në Pejë. Mësimet e mesme i kreu në Medresenë e Madhe të Gjakovës (1924). Pas përfundim të medresesë, për disa vjet kreu detyrën e imamit në xhami të ndryshme, si në Gjakovë, në fshatra të Pejës e deri në Shtip të Maqedonisë. Pas Luftë së Dytë Botërore u angazhua në riorganizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në themelimin e institucioneve udhëheqëse, arsimore e kulturore të Bashkësisë Islame në Kosovë. Në konferencën e përgjithshme të nëpunësve fetarë (1947) u zgjodh kryetar i kryesisë, kryetar i Kuvendit të Vakëfit dhe kryetar i Këshillit të Kuvendit të Bashkësisë të Fesë Islame të Serbisë me seli në Prishtinë. Me iniciativën dhe angazhimin e tij, më 1951 nisi punën Medreseja e Ulët Shqiptare e Prishtinës, ku përveç si pedagog i lëndëve kryesore, ishte edhe drejtor i saj (1953-1956). Më 1951 themeloi Bibliotekën Qendrore të Vakëfit në Prishtinë. Ishte nismëtar i literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë. Së bashku me Mehmet Gjevorin botuan të përkthyer “Ilmihalin” dhe “Jasini Sherifin” (1957) dhe me këtë zuri fill veprimtaria botuese islame në gjuhën shqipe në Kosovë. (Ramadan Shkodra)

AGANI Hilmi (1927-1994). Gjuhëtar, përkthyes, profesor universiteti, publicist. Lindi në Gjakovë. Si pjesëmarrës i Lëvizjes Antifashiste u burgos më 1942. Shkollën e fillore e kreu në Gjakovë,



HILMI AGANI

gjimnazin në Prishtinë, ndërsa u diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd. Po aty i kreu studimet pasuniversitare. Tezën e doktoratës “Fjalori i Lubomir Kujunxhiqit dhe treva gjuhësore e tij” e mbrojti më 1977 në Prishtinë. Ishte ndër profesorët e parë të Universitetit të Prishtinës, si ligjërues i lëndës sintaksë e gjuhës shqipe. Një kohë ishte edhe redaktor i revistës “Zani i rinisë”. Veprimtaria e tij shkencore ka një shtrirje të gjerë, si në gramatikë, në dialektologji, në leksikologji, në historinë e letërsisë, në studime për folklorin, në fushë të studimeve letrare. Në fushë të gjuhësisë dallohen studimet e tij për trevën gjuhësore të Fjalorit të Kujunxhiqit, për kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit e të rasës në të folmen e qytetit të Gjakovës, për Fjalorin e Kujunxhiqit në dritën e shqipes së Rahovecit dhe të Gjakovës, një studim për grafinë dhe fonetikën e Gjon Nikollë Kazazit (1975), për ninullat në letërsinë popullore shqipe etj. Në fushën e studimeve letrare botoi përmbledhjen “Gjurmë”, ku përfshihen studime për poezinë e F. Nolit, të N. Frashërit, të E. Mekulit etj. Në librin për Fjalorin e Kujunxhiqit (1981) ka dëshmuar se ai nuk e paraqiste të folmen e Gjakovës, por të Rahovecit me rrethinë dhe sillte shumë diskutime për të folmet e këtyre hapësirave. Përshtkrimet e tij për të folmen e Gjakovës vlejnë gjithnjë si më të rëndësishmet. Në studimet për togfjalëshin dhe për sinkretizmin e rasave ka sjellë horizont tjetër diskutimi në studimet sintaksore shqiptare të kohës. Botoi tekstin e parë universitar në Kosovë, “Letërsia popullore shqiptare” (dispensë, Prishtinë 1964). Përkthyeu veprën “1001 net” në disa vëllime (1978), si dhe disa vepra të letërsisë jugosllave. (Bahri Koskoviku)

AGANI Mentor (1962-). Sociolog, përkthyes dhe hulumtues. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet themelore në Fakultetin e Elektroteknikës të Universitetit të Prishtinës (UP) më 1994, ndërsa

ato pasuniversitare në Universitetin e Pitsburgut, në SHBA. Mbrojti tezën e doktoratës në fushën e teorive të nacionalizmit në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës më 2013. Gjatë vitit akademik 2006-2007 ka qenë studiues-hulumtues në Universitetin e Harvardit. Është autor i disa punimeve të botuara në disa revista përëndimore. Ka ligjëruar në universitete jashtë vendit në cilësinë e profesorit vizitor. Përktheu në gjuhën shqipe disa libra nga fusha e teorive të nacionalizmit dhe të sociologjisë së politikës. Nga viti 2003 është ligjërues i angazhuar në departamentin e sociologjisë të UP-së dhe nga viti 2014 punon si hulumtues i lartë në Institutin Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED). (Ardian Gola)

AGOLLI Fatmir (1932-1987). Inxhinier i teknologjisë, profesor universiteti. Lindi në Tiranë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Ohër. Kreu studimet në



FATMIR AGOLLI

Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Beogradit (1958). U punësua në kombinatin “Trepça” në Mitrovicë, si drejtor i shkrites së plumbit, udhëheqës i metalurgjisë dhe i rafinerisë, zëvendësudrejtor i përgjithshëm i “Trepçës”, anëtar i këshillit drejtues të kombinatit dhe drejtor i Institutit “Trepça”. U angazhua edhe në punë kërkimore-shkencore. Ishte autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale të botuara në revista e përmbledhje studimesh. Kreu disa specializime në botën e jashtme dhe ishte pjesëmarrës në shumë simpoziume dhe konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Kishte një veprimtari të gjerë dhe në procesin arsimor, në Shkollën e Lartë Teknike dhe në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik të Mitrovicës, duke kaluar procesin e zgjedhjeve nga ligjëruesi deri te titulli profesor ordinar. F. Agolli është autor i dy teksteve universitare: “Teknologjia kimike inorganike” (1983) dhe “Metalurgjia e metaleve të zeza” (1987). (Minir Dushi)

AGOLLI Nexhat (1914-1949). Jurist, pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare në Maqedoni. Lindi në Dibër të Madhe. Shkollimin e kreu në Dibër, Kukës, Vlorë, Tiranë, ndërkaq në vitin



NEXHAT AGOLLI

1937 i kreu studimet për drejtësi në Romë. Punoi si praktikant në gjykatën e Tiranës dhe më pas në gjykatën në Gjakovë. Në vitin 1943 kthehet në Maqedoni dhe përfshihet në radhët e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ishte komisar politik i Brigadës IV Sulmuese Shqiptare dhe mori pjesë në çlirimin e Dibrës, Kërçovës, Gostivarit dhe Tetovës. Pas luftës u zgjodh deputet i Maqedonisë dhe deputet federativ në Beograd për rrethin e Tetovës, më pas zëvendëskryeministër dhe ministër i Asistencës Sociale në Qeverinë e parë të Maqedonisë. Jep kontribut të çmuar në hapjen e shkollave shqipe dhe në arsimimin e popullsisë, emancipimin e gruas etj. Pas Rezolutës së Informbyrosë, më 23 tetor 1948 burgoset nga agjentët e sigurimit shtetëror dhe më 28 prill 1949 vritet në Burgun e Idrizovës në Shkup, me arsyetimin se kishte bërë përpjekje të arratiset. Nuk dihet si është vrarë dhe ku është varrosur. Në Shqipëri është shpallur Dëshmor i Kombit, ndërsa në Kosovë është dekoruar me medaljen e Urdhrit të Lirisë. (Sulltane Ukaj)

AGOLLI Qemal (1918-1995). Veprimtar antifashist. Lindi në Dibër. Në vitin 1930 familja e tij u shpërngul në Tiranë. Pasi mori arsimimin bazë, studioi filozofinë në Firencë të Italisë. Së bashku me studentë të tjerë u kthye në atdhe për t’iu bashkëngjitur rezistencës kundër pushtuesit italian. Veprimtarinë luftarake e filloi në rrethin e Dibrës. Ishte një nga udhëheqësit e njësiteve partizane të Shqipërisë e të Maqedonisë. Mori pjesë në çlirimin e Dibrës, Kërçovës, Gostivarit e Tetovës, si dhe në lirimin e të burgosurve shqiptarë në Monopolin e Tetovës. Ishte pjesëmarrës i Mbledhjes së Parë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Maqedonisë të mbajtur më 2 gusht të vitit 1944. Pas Luftës së Dytë Botërore kreu detyra të rëndësishme në Maqedoni dhe në nivel federativ, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë. Pas Rezolutës së Informbyrosë, aktiviteti i tij hetohet nga UDB-ja. Arrestohet në nëntor të vitit 1948. Më 4 qershor 1949, Gjyqi Ushtarak në Beograd e dënoi me 20 vjet burg të rëndë.

Dënimin e vuajti në Idrizovë të Shkupit, ndërkaq në vitin 1951 e transferuan në Burgun e Goli Otokut, ku qëndroi deri në vitin 1962. Pjesën tjetër të jetës e kaloi në Sarandë, Elbasan dhe Tiranë. (Sulltane Ukaj)

AGOLLI Urfi (1912-1937). Luftëtar antifashist dhe pjesëmarrës në Luftën Civile të Spanjës. Lindi në Dibër. Shkollën fillore e kreu në Selanik (Greqi), ndërkaq shkollën e mesme e ndoqi në Liceun e Korçës. Më 1930 përfundoi mësimet në kolegjin ushtarak në Romë dhe vazhdoi mësimet në Akademinë Ushtarake të Modenas në Itali. Për shkak të qëndrimeve politike ishte i përndjekur nga regjimi i Zogut: u përjashtua nga Liceu i Korçës e më pastaj nga Akademia Ushtarake. Pas kthimit në Shqipëri, jetoi për një kohë në Dibër të Madhe, por qeveria jugosllave shumë shpejt e internoi në Novi Sad. Pas kthimit nga Novi Sadi, emigroi në Francë, ku punoi për një kohë të shkurtër dhe u kthye sërish në Shqipëri. Qeveria e Zogut e burgosi për aktivitet politik (1935), por u lirua brenda vitit. Në janar të vitit 1936 emigroi sërish në Francë, ku u ndodh edhe kur shpërtheu lufta qytetare e Spanjës. U. Agolli iu bashkua Brigadës internacionaliste “Garibaldi”. U vra në luftime në Cuesta de la Perdices, në afërsi të Madridit. (Mrika Limani)

AGROBIZNESI. Biznes bujqësor bashkëkohor i prodhimit dhe i shpërndarjes së produkteve agroushqimore. Përshkruhet si aktivitet për kontrollin e tregut të ushqimit. Njihet edhe me terma si kompleksi i agrobiznesit, kompleksi agroindustrial etj. Në veprimtarinë e agrobiznesit marrin pjesë operacionet me karakter agroushqimor, të cilat kanë të bëjnë me prodhimin dhe shpërndarjen e inpueteve, operacionet në fermë, grumbullimin, magazinimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve agroushqimore. Në agrobiznes rëndësi të veçantë kanë fermat familjare. Ato janë format bazë të organizimit të prodhimit bujqësor, të cilat hyjnë pastaj në zinxhirin e transformimit dhe të distribuimit si produkte të freskëta apo të përpunuara. Në Kosovë koncepti i prodhimit të ushqimit në parimet e agrobiznesit ka filluar të realizohet në fillim të viteve '60, kur janë formuar ndërmarrjet shoqërore për prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Më vonë u formuan kombinatat agroushqimore në rajonet e ndryshme të



KORRJE-SHIRJET NË KOSOVË

Kosovës. Sistemin e kombineve e përbënin ndërmarrjet bazë, të organizuara sipas parimit të integritimit vertikal (nivele të transformimit të produkteve bujqësore) dhe horizontal (në bazë të diversifikimit organizativ). Kombinatat kanë qenë të integruara në organizatën e përbërë të punës së bashkuar “Agrokosova”, e cila kishte rolin koordinues në zhvillim dhe afarizëm të përbashkët të prodhimit të ushqimit në Kosovë. Sektori shoqëror me 10% të sipërfaqeve bujqësore ishte i përqendruar kryesisht në prodhimin e ushqimit brenda sistemit agroindustrial “Agrokosova” dhe vetëm pjesërisht në bazë të kooperimit me sektorin privat, i cili përbënte potencialet dominuese prodhuese. Pas vitit 1999, në bazë të transformimit pronësor të pronave shoqërore, kapacitetet agroindustriale u privatizuan, duke iu ndërruar destinimi, me çka u shpërbë një sistem i tillë i agrobiznesit. Aktualisht zhvillimi i agrobiznesit në Kosovë bazohet në zhvillimin e fermave dhe të ndërmarrjeve të specializuara për prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. (Halim Gjergjizi)

AGUSHI Alush (1959-). Lindi në fshatin Drenoc të Klinës. Gjatë studimeve në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë u inkuadrua në grupet ilegale. Për këtë shkak u arrestua dhe u dënua me një vit burg nga gjykata e Pejës. Pas daljes nga burgu emigroi në Zvicër, ku gjithashtu u angazhua në lëvizjen politike. Pas shpërthimit të luftës, u kthye në Kosovë dhe në

betejën e 29 e 30 qershorit të vitit 1998, e cila u zhvillua në vendlindjen e tij, ai e udhëhoqi luftën dhe e mbajti frontin plot tri ditë me 39 bashkëluftëtarët e njësitit të tij. Pas kësaj beteje u emërua udhëheqës i njësitit gueril 192 të UÇK-së deri në formimin e brigadave të UÇK-së. Njësi gueril 192 ishte njësit mobil i lidhur drejtpërdrejt me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, ndërsa në prill 1999 u emërua komandant i Policisë Ushtarake të UÇK-së. Pas përfundimit të luftës kreu detyrën e inspektorit të përgjithshëm në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. (Haki Kasumi)

AGUSHI Aurita (1977-). Aktore. Lindi në Gjiilan, ku e kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës



AURITA AGUSHI

(2002). Interpretoi një sërë rolesh në shfaqjet, shumica syresh në Teatrin Kombëtar të Kosovës: “Bunari afër shtëpisë” (2003), “Nivana” (2007), pastaj “Fizikanët” (2011), “Lisistrata” (2012), “Vorbulla” (2014), “Lufta në kohën e dashurisë” (2015, Qendra Multimedia në Prishtinë). Në produksion të Shtëpisë teatrore-filmike “Monoakt” ka luajtur në shfaqjen “Trojanët” (2015). Është angazhuar edhe në seriale televizive dhe në filma të metrazhit të gjatë: “Kukumi” (2005), “Agnus Dei” (2012), “Tri dritare dhe një varje” dhe “Babai” (2015). Për kreacionet artsitike mori një sërë çmimesh në festivalet vendore dhe ndërkombëtare. Punon në Teatrin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë. (Besim Rexhaj)

AGUSHI Ilaz (1903-1943). Veprimtar i çështjes kombëtare, antikomunist. Ishte i biri i Xhemajl Agushit. Lindi në Prishtinë. Mësimet fillore i kreu në Prishtinë, ndërsa Kolegjin e Diturive Filozofike e mbaroi në Stamboll. U punësua në postën e Stambollit, ku nisi aktivitetin politik kombëtar, duke u lidhur me Komitetin Shqiptar të Stambollit dhe me Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Nga fundi i viteve ’20 dhe ’30 të shek. XX, I. Agushit iu besua administrimi i vakëfit të Bashkësisë Islame të Prishtinës. Nga pjesa e dytë e viteve ’30 e gjejmë anëtar të këshillit drejtues

të Organizatës së Myslimanëve dhe drejtor të vakëfit në Shkup. Më 1938 u zgjodh deputet në Parlamentin e Mbretërisë së Jugosllavisë për rrethin e Ferizajt. Më 1941 kontribuoi në vendosjen e udhëheqjes shqiptare në komunën dhe prefekturën e Prishtinës, si prefekti i parë shqiptar. Kontribuoi gjithashtu në hapjen e Liceut “Sami Frashëri” në Prishtinë. Ishte ministër, sekretar shteti për Punë Botërore në Tiranë në kabinetin e Mustafa Krujës nga 3 dhjetori 1941 deri më 14 shtator 1943. Për ribashkimin dhe mbrojtjen e Rozhajës, të Bihorit, të Sjenicës dhe të Novi-Pazarit, I. Agushi me shpenzimet familjare rekrutoi dhe armatosi 6,000 vullnetarë. Mbante kontakte dhe lidhje me Fadil Hoxhën, përmes Hajdar Dushit. Pati takim konfidencial me Fadil Hoxhën në Ferizaj. Më 28 tetor 1943 u organizua atentat në shtëpinë e tij. Vrasjen e mori mbi vete Shtabi i Përgjithshëm i Aradheve Partizane të Kosovës. (Adem Murati)

AGUSHI Kurtesh (1910-1989). Pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare, funksionar politik. Lindi në Gjiilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Vrajë e Leskocv,



KURTESH AGUSHI

ndërsa Fakultetin Juridik në Beograd (1938). Aty iu bashkua rinisë komuniste dhe studentore jugosllave. Mori pjesë në aksionet politike kundër pushtetit. Me iniciativën e tij më 1938 u shtyp një afishe në gjuhën shqipe dhe serbe kundër marrëveshjes jugosllave-turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Pasi hetoi aktivitetin e tij, policia e burgosi dhe gjyqi e dënoi me vdekje. Me rënien qeverisë së Milan Stojadinoviçit, u amnistua. Më pas u shpërngul në Shkup. Ishte njëri nga organizatorët e demonstratës antibullgare në Shkup në vitin 1941. Po atë vit kthehet në Gjiilan dhe bëhet kryetar i komunës së Kamenicës. Më 1942 bëhet anëtar i celulës së parë komuniste në Gjiilan, ndërkohë pushohet nga detyra e kryetarit të komunës. Me formimin e Aradhes partizane “Zejnel Hajdini” u zgjodh komisar politik i aradhes. Mori pjesë në aksionin e Carralëvës dhe në disa aksioneve të tjera të kësaj aradhe. Po atë vit burgoset dhe mbahet në burg deri në kapitullimin e Italisë. Në qershor të vitit 1944 u burgos nga

gjermanët, u dërgua në Kampin e Prishtinës dhe që andej u internua në Vjenë. Pas kthimit nga internimi në qershor 1945 mori detyrën e ndihmësit të prokurorit publik në Ferizaj dhe Prizren. Në zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës u zgjodh deputet federativ dhe ishte anëtar i forumeve krahinore në Kosovë. Më 1956 u shpërngul në Shkup, ku më 1963 u pensionua. (Fehmi Rexhepi)

AGUSHI Ramadan (1919-1991). Pjesëmarrës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNDSH), i burgosur politik. Lindi në Tërpezë të Vitisë. Kreu Medresenë e Shkupit dhe Shkollën Normale “Sami Frashëri” në Prishtinë (1943). Punoi si mësues në fshatrat Novosellë dhe Radac të Pejës. Ishte përkrahës i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Nuk u pajtua me rikthimin e pushtetit jugosllav në Kosovës më 1944. Mori pjesë në Kuvendin e Tërpezës dhe bashkëpunoi me Hysen Tërpezën. Më 1945 u dënua nga gjyqi ushtarak në Ferizaj, por më pas lirohet. Një vit punoi si mësues në Gjilan, por si pjesëtar i Komitetit Qarkor të LNDSH-së në Gjilan në tetor të vitit 1946 arrestohet. Në procesin gjyqësor kundër veprimtarëve të LNDSH-së në Gjilan, u dënua më 7 vjet burg, të cilat i mbajti në Mitrovicë të Sremit. Më 1954 u lirua nga burgu dhe deri më 1957 punoi si mësues në Kabash, Pozhoran të Vitisë dhe Lluqan të Bujanocit. Nga viti 1960 deri më 1963 punoi si mësues në Gjilan. Në fund të vitit shkollor 1962/63 përjashtohet nga procesi mësimor. Më pas punoi si përkthyes në Kombinatin e Duhanit në Gjilan, deri në vitin 1986. Dha kontribut të çmuar edhe në teatrin amator të Gjilanit. U angazhua kundër të gjitha padrejtësive ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, mbështeti lëvizjen e rezistencës dhe, së fundi, edhe pluralizmin demokratik në Kosovë. (Adem Murati).

AGUSHI Zahir (1951-1999) Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Drenoc të Klinës. Pasi kreu shkollën fillore dhe të mesme në Drenoc dhe në Gjakovë, kreu studimet për bujqësi në Prishtinë. Më 1980 u punësua në Kombinatin bujqësor-industrial “Malishgan” në Klinë, ku punoi si inxhinier i bujqësisë deri në vitin 1990. Kishte gradën e kapitenit rezervë të fituar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak në ushtrinë jugosllave. Në radhët e UÇK-së u angazhua në qershor të vitit 1997, në kuadër të njësitit gueril

të Drenocit. Mori pjesë në aksione luftarake kundër forcave policore serbe, por edhe në aksione për furnizim me armë nga Shqipëria për zonën e Dukagjinit dhe të Drenicës. Më 10 shtator 1998, tek Ura e Gurit në Klinë ra në pritën e forcave serbe, me ç’rast u arrestua. E keqtrajtuar në stacionin e policisë serbe në Klinë, në Burgun e Pejës, në Burgun e Lipjanit dhe në atë të Dubravës. U ekzekutua nga forcat serbe më 22 maj 1999 në Burgun e Dubravës bashkë me dhjetëra të burgosur të tjerë. Pas përfundimit të luftës, trupi i tij u gjet në varrezën masive në Rakosh të Istogut, ndërsa edhe pas vdekjes u dënua me 15 vjet burg, në një proces gjyqësor të mbajtur në Leskovc të Serbisë. (Fetnete Ramosaj)

AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA). Agjenci publike, e pavarur për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë. Ka bazë ligjore për akreditimin e të gjitha institucioneve që ofrojnë programe të arsimit të lartë dhe që japin grada akademike sipas Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës (2011). Përmes procesit të vlerësimit dhe të kontrollit të cilësisë dhe të faktorëve të tjerë, AKA-ja lejon jetësimin e programeve të studimit, siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë t’u përafrohen sa më shumë kërkesave dhe pritjeve të rrjetit europian të asociacioneve për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Ajo njofton Ministrinë e Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) për kërkesat e institucioneve për licensimin e programeve të tyre, inspekton bartësit e arsimit të lartë, kontrollon dhe vlerëson cilësinë e programeve në mënyrë periodike, bashkëpunon me MASHT-in lidhur me rezultatin e vlerësimit të cilësisë, shpall politikat, kriteret dhe standardet e saj të akreditimit etj. (Naser Zabeli)

AGJENCIA E PRIVATIZIMIT E KOSOVËS (APK). Institucion i themeluar më 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), me pak ndryshime. Të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së i janë transferuar AKP-së. Agjencia ka mandat që të përmbyllë procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, përderisa përgjegjësia mbi ndërmarrjet publike është transferuar te Qeveria e Kosovës. Që nga

themelimi i saj, AKP-ja ka vijuar procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në të njëjtën mënyrë si AKM-ja dhe ky proces tani është në fazën përfundimtare. (Alban Hashani)

AGJENCIA E STATISTIKAVE E KOSOVËS.

Institucion profesional i pavarur, bartës dhe shpërndarës i statistikave zyrtare dhe koordinator i statistikave zyrtare të Kosovës, i themeluar më 1948. Pas nëntë vitesh ndërprerjeje të të gjitha serive kohore të Kosovës, më 2 gusht 1999 Agjencia ka rifilluar punën si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa që nga dhjetori i vitit 2011 vepron në kuadër të zyrës së kryeministrit. Sipas legjislacionit në fuqi, Agjencia është përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje që parashihen në programin e statistikave zyrtare. Është e organizuar në shtatë departamente, ku përfshihen katër departamente operationale, që mbulojnë këto fusha statistikore: statistikën e bujqësisë dhe të mjedisit, regjistrimet dhe anketimet, statistikën ekonomike dhe statistikën sociale, duke përfshirë statistikën e popullsisë. (Ardiana Gashi)

AGJENCIA E USHQIMIT DHE E VETERINARISË SË KOSOVËS (AUVK).

Është institucioni më i lartë për ushqim dhe veterinarinë në Kosovë, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve përmes sigurimit të ushqimit cilësor, për përkujdesje ndaj kafshëve dhe shëndetit të tyre, si dhe të cilësisë së ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore. Është autoritet qeveritar për zbatimin e inspektimeve në fushën e sigurisë, higjienës, të gjurmimit dhe të etiketimit të ushqimit për njerëz dhe kafshë. Në fushën e veterinarisë AUVK-ja siguron monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të kafshëve, zoonozave dhe mirëqenien e kafshëve, parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve dhe eliminimin e tyre. AUVK-ja zbaton politikën qeveritare me përdorimin e projekteve kapitale dhe organizon kontrolle zyrtare në kufij dhe brenda territorit të Kosovës. Në përbërje të AUVK-së funksionojnë këto njësi: laboratorit i ushqimit dhe i veterinarisë, njësia për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe drejtoria e shëndetit publik. (Xhevat Domi)

AGJENCIA E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR (AZHN).

Fond i Bankës Botërore për më të varfrit, i themeluar në vitin 1960 si degë e Bankës Botërore për financimin e rritjes ekonomike të vendeve në zhvillim. Bën financimin e një spektri të gjerë të projekteve të natyrës zhvillimore, përmes të cilave nxitet rritja ekonomike dhe përmirësohen kushtet e jetesës në vendet e varfra. AZHN-ja ofron kredi me norma shumë të ulëta të interesit, me periudhë të gjatë të kthimit (25-38 vite). Ajo mbështet edhe lirin nga borxhi të vendeve në zhvillim. Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, AZHN-ja ka financuar një sërë projektsh kryesisht në fushën e arsimit, të energjisë, të zhvillimit të komuniteteve, si dhe të përmirësimit të mjedisit afarist. Nga Banka Botërore janë paraparë pesë projekte të reja, të cilat do të financohen përmes granteve dhe kredive të AZHN-së, siç është ai për energjinë dhe energjinë e ripërtëritur, për furnizimin me ujë, për arsimin dhe shëndetësinë. Projektet për energjinë dhe për shëndetësinë janë aprovuar nga Banka Botërore në vitin 2014 dhe pritet që implementimi i tyre të zgjasë deri në vitet 2019-2020. (Venera Demukaj)

AGJENCIA KOSOVARE E MIRËBESIMIT

(AKM). Institucion përgjegjës me mandat për të privatizuar ndërmarrjet shoqërore dhe për të administruar ndërmarrjet publike në Kosovë. U themelua në vitin 2002 nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). AKM-ja ka qenë përgjegjëse për të ruajtur vlerën dhe qëndrueshmërinë afariste të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë. Agjencia ka pasur mandat që të kryejë procedurat e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore përmes “spin off-it” (të rregullt dhe special), apo përmes likuidimit. AKM-ja ka marrë në mirëbesim dhe nën mbikëqyrje për t'i privatizuar mbi 500 ndërmarrje të tilla në Kosovë. Një numër i këtyre ndërmarrjeve nuk kanë qenë funksionale, kryesisht për shkak të rrethanave gjatë dekadës pararendëse, që e ka paraprirë këtë proces. Ndërkaq, sa u përket ndërmarrjeve publike, AKM-ja ka pasur mandat që t'i transformojë ato në korporata moderne. Agjencia ka marrë përsipër që të administrojë këto ndërmarrje publike: Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës

(KEK), Hekurudhat e Kosovës, ndërmarrjet rajonale të ngrohjes në Gjakovë dhe Prishtinë, ndërmarrjet e ujit, të mbeturinave dhe ujitjes, si dhe Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PTK). AKM-ja ka bërë transformimin e këtyre ndërmarrjeve në subjekte të veçanta dhe ka vlerësuar asetet dhe detyrimet e tyre. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, AKM-ja është shpërbërë dhe si trashëgimtare e saj është themeluar Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). (Alban Hashani).

AGJENCITË DOGANORE. Biznese që e lehtësojnë procesin e zhdoganimit të mallrave në kufi, duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për import dhe eksport të mallrave. Sot në Kosovë operojnë rreth 300 biznese të shpedicioneve. Shpedicionet regjistrohen si të gjitha bizneset në Kosovë, mirëpo që të jenë operative, duhet të kalojnë edhe një formë të regjistrimit në Doganat e Kosovës, ku agjentët doganorë pajisen me numra identifikues dhe iu ofrohet qasje në sistemin e teknologjisë informative të doganave, përmes të cilit e realizojnë një fazë të procesit të zhdoganimit të mallrave (përpunimin e dokumentacionit). Me qëllim të rregullimit të sektorit, aktualisht Dogana e Kosovës është duke punuar në ndërtimin e bazës ligjore, e cila do të përcaktojë kushtet e licencimit të shpedicioneve dhe agjentëve doganorë. (Petrit Gashi)

AGJENCITË E LAJMEVE DHE PORTALET. Që nga viti 1990, një nga burimet kryesore të prodhimit dhe të shpërndarjes së informatave në Kosovë ishte Qendra për Informim e Kosovës (QIK), e ngritur në kuadër të kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Grumbullimin e informatave nga terreni QIK-u e bënte përmes një rrjeti të gjerë bashkëpunëtorësh, kryesisht të ngarkuarit për informim në kuadër të degëve dhe nëndegëve të shumta të LDK-së. Kjo qendër dy herë në ditë botonte dhe distribuonte informatat kryesore nga ngjarjet në Kosovë, shqip, anglisht dhe pjesërisht në gjuhën gjermane. Gjatë viteve '90, ndonëse nuk u quajt e tillë, kishte karakteristikat e një agjencie të lajmeve. Ndërkohë, më 4 janar 1999 filloi punën agjencia e lajmeve "Kosovapress", e cila kishte qëllim kryesor shpërndarjen e lajmeve për zhvillimet e fundit në Kosovë, kryesisht për luftën e UÇK-së. Pas vitit 1999 krijohet agjenci të reja informuese, si "Kosova Live", "Telegrafi" etj.

Ndërkohë, edhe në Kosovë fillon një fazë e re e përhapjes së informimit përmes internetit. Interneti si mjet informimi në Kosovë së pari është përdorur nga Qendra për Informim e Kosovës (QIK), e cila që nga viti 1991 filloi të shpërndante informatat nga Kosova përmes internetit. Pas luftës (1999), në Kosovë u hapën edhe mjete të tjera të informimi përmes shfletimit në internet. Por hovin më të madh të zhvillimit e morën disa vjet më pas. Ndër portalet që revolucionarizoi këtë lloj të tregut medial në Kosovë është portali "Telegrafi.com" (2006). Trendi i krijimit të medieve online erdh gjithnjë në rritje, ndërsa aktualisht është një numër i madh i portaleve që funksionojnë rregullisht. Ndërkohë të përditshmet kosovare që dilnin në format të shtypur, nisën të ofrojnë përmbajtjet e tyre edhe në internet, si: "Koha.net" ("Koha ditore"), "Zëri", "Kosova sot", "Epoka e re", "Bota sot" etj. Ndërkaq "Gazeta Express" e "Tribuna" mbyllën tërësisht shërbimet e tyre në letër, për të kaluar vetëm në platformën online. Nga ana tjetër, shumë portale kanë marrë emërtimin "Gazetë", edhe pse janë shfaqur vetëm online, si "Gazeta Blic", "Gazeta Fjala", "Gazeta Jeta në Kosovë" etj. Ndër portalet e tjera më të klikuara në Kosovë janë edhe "Indeksonline.net", "Lajmi.net", "Politiko.net" dhe "Insajderi.com". Po ashtu ekzistojnë edhe dhjetëra portale në nivel lokal, si "Veriu.info" (Mitrovicë), "Rajoni Press" (Gjilan), "Radio Gjakova", "Prizren Press", "Theranda Post", etj. Informatat me përditësim të shpejtë i transmetojnë në portale edhe agjencitë e lajmeve "Kosova Press" dhe "Kosova Live", "Ekonomia Online", pastaj televizionet RTK, RTV-21 e "Klan Kosova", si dhe programet në gjuhën shqipe të medieve ndërkombëtare: Radio "Evropa e Lirë", Radio "Deutsche Welle", "Zëri i Amerikës", "Anadolu Agency" etj. (Ibrahim Berisha, Artan Krasniqi)

AGJENCITË E PAVARURA TË KOSOVËS. Institucione të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. Funkcionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur, duke qenë të mbrojtura me Kushtetutë dhe me ligj nga ndikimet që cenojnë mëvetësinë e tyre politike dhe vepruese. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me ligjin, por pa një model unik të buxhetit për të gjitha agjencitë. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër,

që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, në pajtim me ligjin. (Ilir Dugolli)

AHMA Luan (1958-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, arsimimin bazë e mori në Prishtinë, studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1981). Pas diplomimit punoi në shtypshkronjën "Rilindja" në Prishtinë, si inxhinier i mirëmbajtjes të sistemit kompjuterik. Në vitin 1983 u zgjodh asistent në katedrën e elektroteknikës teorike. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në UP (1997). U zgjodh ligjërues, më pas docent dhe profesor ordinar (2003) për lëndët bazat e elektroteknikës dhe qarqet elektrike. Kreu detyra me përgjegjësi në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të UP-së. Si autor dhe bashkautor publikoi një sërë punimesh shkencore në revista të vendit dhe ato ndërkombëtare. Është bashkautor i tekstit universitar "Përmbledhje detyrash nga bazat e elektroteknikës", autor dhe bashkautor i disa dispansave, i teksteve për shkolla të mesme profesionale etj. Është i angazhuar edhe në projekte të ndryshme ekonomike dhe arsimore. (Isuf Krasniqi).



LUAN AHMA

studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në UP (1997). U zgjodh ligjërues, më pas docent dhe profesor ordinar (2003) për lëndët bazat e elektroteknikës dhe qarqet elektrike. Kreu detyra me përgjegjësi në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të UP-së. Si autor dhe bashkautor publikoi një sërë punimesh shkencore në revista të vendit dhe ato ndërkombëtare. Është bashkautor i tekstit universitar "Përmbledhje detyrash nga bazat e elektroteknikës", autor dhe bashkautor i disa dispansave, i teksteve për shkolla të mesme profesionale etj. Është i angazhuar edhe në projekte të ndryshme ekonomike dhe arsimore. (Isuf Krasniqi).

AHMEDI Fikret (1943-). Inxhinier i ndërtimtarisë, profesor universiteti. Lindi në Preshevë, ku kreu shkollën fillore, kurse të mesmen e kreu në Shkup. Kreu studimet në Fakultetin



FIKRET AHMEDI

studimet në Fakultetin e Ndërtimtarisë të Universitetit të Lubjanës. Pas studimeve u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe më vonë profesor për lëndët mekanika e dherave dhe fundamentet. Mbrojti disertacionin në Universitetin e Prishtinës (UP) nga lëmi i gjeoteknikës. Kreu specializimin nga fusha shkencore e

gjeomekanikës në Universitetin e Krakovës dhe Vroclavit në Poloni. Është autor i teksteve universitare "Mekanika e dherave" (1989) dhe "Fundamentet" I, II (2002, 2009). Si anëtar i Shoqatës Jugosllave për Mekanikë të Dherave dhe Fundamente dhe i Shoqatës për Mekanikë të Shkëmbinjve mori pjesë në simpoziumet e këtyre shoqatave në vende të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Për tri dekada udhëhoqi laboratorin e gjeomekanikës në Institutin e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe ishte prodekan e dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së. Përpiloi bazat e hartave gjeoteknike dhe kreu shqyrtime të shumta gjeomekanike dhe vlerësime të stabilitetit të pjerrësirave në tërë Kosovën. (Fetah Jaxhiu).

AHMEDI Ismail (1947-). Studiues i gjuhës dhe i letërsisë arabe. Lindi në Zajaz të Kërçovës (Maqedoni). Mori arsimin fillor në vendlindje, kurse atë të mesëm në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Bagdadit në Irak (1972), studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Kuvajtit, ndërsa u doktorua në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1996). Nga viti 1974 punoi si mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë arabe në degën e orientalistikës të UP-së. Gjatë viteve 2004-2006 dhe 2009-2012 ishte prorektor për arsim në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Është autor i një sërë studimesh mbi gjuhën dhe letërsinë arabe, si dhe mbi kulturën islame të botuara në shtypin shkencor brenda dhe jashtë vendit. Është autor i disa veprave për gjuhën dhe letërsinë arabe: "Prozë e sotme arabe" (1982), "Kultura arabe në Maqedoni dhe Kosovë prej shek. XV-XVIII" (1997); "Hafiz Ali Korça - Jeta dhe vepra" (1999), "Gjuha bashkëkohore arabe", etj. (Hatixhe Ahmedi)

AHMEDI Lule (1971-). Inxhinier e elektroteknikës, profesore universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet e inxhinierisë elektrike në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1998). Studimet e doktoratës i mbaroi në Gjermani (2004), ku ishte e angazhuar në mësimdhënie dhe kërkime shkencore (1999- 2004). Ishte e angazhuar si ligjëruese në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë (2005-2010) dhe mbajti ligjërata në Suedi dhe Turqi. U zgjodh mësimdhënës

për lëndët bazat e të dhënave dhe programimi në internet në UP (2011). Bashkëpunon me shumë universitete të Europës në projekte të ndryshme shkencore dhe është recensente e disa revistave shkencore. Është autore e një sërë punimesh shkencore dhe profesionale në lëmin e uebit semantik, baza e të dhënave dhe nxjerrja e informatave. Kreu një sërë projektesh ndërkombëtare shkencore. Është autore e studimeve mbi gjendjen aktuale dhe perspektivën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në Kosovë (2013). Aktualisht jeton në Prishtinë. (Enver Hamiti).

AHMEDI Nexhat Efendi (1904-1984).

Titullar i fesë islame nga Presheva. Shkollimin fillor e kreu në Preshevë, mori mësimet në Medresenë e Preshevës dhe i vazhdoi në Shkup, në Medresenë "Meddah". Kreu specializimin për gjuhë arabe në Universitetin "Al-Az'har" të Kajros në vitin 1928. U emërua myderriz dhe drejtues i Medresesë së Preshevës më 1934, detyrë që e kreu deri në vdekje. Pasi shteti jugosllav e mbylli Medresenë e Preshevës, N. Ahmedi e ktheu shtëpinë e vet në medrese dhe aty vazhdoi aktivitetin e tij arsimor. Mbajti ligjërata edhe në xhamitë e Preshevës. Për dy dekada ishte edhe myfti dhe kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Preshevës dhe anëtar i kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. U shqua për angazhimin e tij kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. La trashëgim një bibliotekë të pasur me libra të botuara dhe në dorëshkrim. (Hatixhe Ahmedi)

AHMEDI Xhemail (1930-). Mjek, gjinekolog, profesor universiteti. Lindi në Preshevë. Mbaroi shkollimin fillor në vendlindje, kurse gjimnazin në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Shkup.



XHEMAIL AHMEDI

Nga viti 1963 punoi në repartin e gjinekologjisë të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës, pastaj në Klinikën e Gjinekologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializoi gjinekologjinë me obstetrikë. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës po nga kjo fushë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 1979. Në vitin 1970 u pranua si asistent i lëndës së gjinekologjisë

dhe obstetrikës, më pas docent i lëndës gjinekologji-akusheri dhe më 1990 mori titullin e profesorit ordinar. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në reparte të ndryshme të Klinikës së Gjinekologjisë. Nga viti 1990, pas largimit nga puna nga organet e dhunshme serbe, merret me veprimtari mjekësore private, por pa u shkëputur nga procesi mësimor në Fakultetin e Mjekësisë, duke e vënë në dispozicion ordinancën e vet private për punën praktike të studentëve. Është autor dhe bashkautor i punimeve shkencore dhe profesionale të botuara brenda dhe jashtë vendit. (Binak Kastrati)

AHMETAJ Halil (1953-). Mjek patofiziolog, imunolog, profesor universiteti. Lindi në Vuthaj të Plavës në Mal të Zi. Mbaroi shkollimin fillor në vendlindje dhe Guci, gjimnazin në Gjakovë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Pas studimeve u pranua si asistent (1978) në Institutin e Fiziologjisë Patologjike. Vijoi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd për alergologji dhe imunologji klinike,



HALIL AHMETAJ

temën e magistraturës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës nga fusha e imunologjisë (1987). U gradua me të gjithë titujt universitarë në Fakultetin e Mjekësisë, përfshirë edhe titullin e profesorit ordinar për lëndën fiziologji patologjike. Në tetor të vitit 1992 u bë anëtar i Akademisë së Shkencave të Nju-Jorkut. Kreu detyra të ndryshme në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Institutin e Fiziologjisë Patologjike. Është bashkautor i teksteve universitare "Pneumoftiziologjia" (1986), "Fiziologjia patologjike e respiracionit" (1987), "Mjekësia inerte" (1999) etj. dhe përkthyes i tekstit "Fispatologjia" (2001). Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit. (Isuf Dedushaj)

AHMETAJ Ibrahim (1943-). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Vuthaj të Plavës (Mal të Zi), u shkollua në vendlindje dhe në Pejë. Në vitin 1967 diplomoi për gjeografi në Universitetin e Prishtinës, magjistroi në Beograd dhe doktoroi në Zagreb në fushën

e gjeomorfologjisë (1984). Një kohë punoi në Prishtinë, më pastaj (2001) në Sarajevë e Tuzëll (Bosnjë dhe Hercegovinë) si profesor universitar. Sa jetoi në Prishtinë bashkëpunoi me Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës, duke përpiluar atlase gjeografike, harta të murit dhe tekste shkollore. Mori pjesë në disa projekte nga fusha e gjeomorfologjisë, mjedisore dhe hartografike. Ishte pjesëmarrës në disa projekte, si për kanionin e Mirushës, për Parkun Nacional të Sharrit, për hartën gjeomorfologjike të Jugosllavisë, ku ishte udhëheqës i punëve të pjesës së Kosovës. Botoi dy monografi shkencore dhe një numër studimesh nga fusha e gjeografisë fizike, mbrojtja e mjedisit, gjeomorfologjia dhe demografia. Jeton në Sarajevë dhe në Vuthaj. (Shpejtim Bulliqi)

AHMETAJ Jeton (1965-). Regjisor, mësimdhënës universiteti. Lindi në Gjiilan, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për regji filmi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është mësimdhënës i regjisë së filmit në Fakultetin e Arteve. Me filmin artistik të metrazhit të gjatë “Gomarët e kufirit” (2010) u prezentua në disa festivale ndërkombëtare. Filmi përqesh me një humor fshikullues sistemet totalitare, ndërsa u prit mirë edhe nga publiku vendës. Realizoi edhe një numër filmash televizivë, dokumentarë dhe të metrazhit të shkurtër: “Unë, Istref Begolli”, “Gremina”, “Fotografia”, “Ankthi”, “Ikja me vdekjen”, “Zogu”, “Zemër e vetmuar”, “Saksofonisti”, “I zhdukuri”. Shkruan skenarë dhe ka bërë regjinë edhe të disa shfaqjeve teatrale. (Gani Mehmetaj)

AHMETAJ Mehmet (1946-). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në Vuthaj të Gucisë. Shkollën e mesme e mbaroi në Pejë, ndërsa studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1974). Kreu studimet pasuniversitare për shkencat filologjike (1986). Në periudhën 1981-2011 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si kuadër shkencor. Doktoroi në shkencat filologjike në Universitetin e Prishtinës në vitin 2000. M. Ahmetaj është autor i veprave “Fjalor i të folmeve shqipe në Mal të Zi” (1996), “E folmja e Plavës dhe Gucisë” (2002) dhe “E folmja e Anës së Malit” (2006). (Sejdi Gashi)

AHMETAJ-ÇITAKU Sala (1950-). Gjuhëtare, profesore universiteti. Lindi në Radishevë të Skënderajt. Shkollën e mesme e kreu në Mitrovicë. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe



SALA
AHMETAJ-ÇITAKU

në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i mbaroi më 1988, ndërsa tezën e disertacionit të doktoraturës e mbrojti më 2009 për teorinë e gjymtyrëve të fjalisë. Ka punuar si mësuese, pastaj mësimdhënëse në gjimnazin e Skënderajt dhe mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1978. Ka botuar një sërë artikujsh nga fusha e sintaksës së gjuhës shqipe. Dy mandate ka qenë deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës (2001-2004, 2004-2007). Veçohen studimet e saj për gjymtyrimin e fjalisë në shqipe, për foljet këpujore, për strukturën e fjalisë së gjuhës shqipe dhe për fjalitë njëkryegjymtyrëshe. (Bahri Koskoviku)

AHMETGJEKAJ Shkumbin (1981-). Gazetar. Lindi në Rudicë të Klinës. Shkollimin e mesëm e kreu në Klinë, studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Prishtinë, ndërsa studimet master i kreu në Londër më 2010. Karrierën e gazetarit e nisi në Radio “Alba” në Klinë, për të vazhduar me Radiotelevizionin 21, ku punoi në periudhën 2003-2005. Nga viti 2005 nisi të punojë në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), ku raportoi për ngjarje të rëndësishme në Kosovë. Ka realizuar shumë intervista me personalitete vendore dhe ndërkombëtare dhe ka punuar një sërë dokumentarësh për mediet ndërkombëtare. Është redaktor në RTK. (Artan Krasniqi)

AHMETI Adem (1926-2010). Veteran i arsimit, veprimtar. Lindi në Preshevë. Fillimisht përvetësoi arsim fetar dhe u aftësua për zejtar. Në vitin 1946 kreu kursin pedagogjik në Prizren, pastaj në Shkup, sërisht në Prizren dhe në Pejë, ku u diplomua për mësues. Studimet për albanologji i filloi në Universitetin e Beogradit dhe i përfundoi në Universitetin e Shkupit në vitin 1959. Si mësues punoi në Bukuroc, Letovicë, Tërrnoc ku ishte edhe drejtor shkolle në Bujanoc, në Rahovicë, në shkollën fillore, përkatësisht në gjimnazin e

Preshevës. Ishte njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe i disa gjuhëve të huaja, lektor tekstesh shkollore dhe i botimeve të tjera, përkthyes në administratën komunale, aktivist në jetën kulturore në Preshevë etj. (Gafur Hyseni)

AHMETI Ali (1945-1995). Mbledhës i folklorit. Lindi në Vuthaj, Mal të Zi. Kreu Shkollën Normale në Pejë, Fakultetin Filozofik, dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare dhe ishte kandidat për disertacionin e doktoratës në Universitetin e Zagrebit. Punoi në arsim dhe ishte mbledhësi i pasionuar i folklorit në krahinën e Plavës dhe të Gucisë, ku mblodhi legjenda, balada, këngë të kreshnikëve, këngë historike, këngë lirike, mallkime, urime, kallëzime, përrallëza, anekdota dhe fjalë të rralla, të cilat kryesisht kanë mbetur të pabotuara. Mori pjesë në tubime shkencore, botoi artikuj e punime studimore. E la në dorëshkrim disertacionin e papërfunduar të doktoratës për këngët e djepit nga Plava e Gucia, punimin për veshjet popullore shqiptare të burrave dhe të grave nga Plava e Gucia etj. Pas vdekjes u botua vëllimi i tij poetik “Kur fiken dritat”. Ishte bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës, ku edhe ruhet dosja me dorëshkrimet e tij. (Zymer U. Neziri)

AHMETI Ali (1945-2011). Aktor. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Studimet për aktrim i kreu në Akademinë për Teatër dhe Film në Beograd.



ALI AHMETI

Prej vitit 1972 luajti në shfaqjet e repertorit të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë në zhanrin e dramës, të komedisë dhe tragjedisë si: “Filokleti”, “Në sytë e klounit”, “Hotel Kashta”, “Makbethi”, “Mosha e bardhë”, “Sfinga e gjallë”, “Era dhe Lisi”, “Varka e Noes”, “Besa e Madhe”, “Dan Shejtani”, “Genci”, “Ngadhënjimi”, “Pas vdekjes”, “Kafexhiu”, “Prefekti”, “Shoku Niqifor”, “Hamleti”, “Dhëndrri nga Parisi”, “Ifigjenia në Aulidë”, “Milionerët”, “Fundi i botës”, “Teatri i vogël i Deli Ukës”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Shprend Sokoli i Sokol Shpendit”, “Burri burrë”, “Alo”, “Lkeni i Hasit”, “Garderobisti”, “Babai” etj. Pas vitit 1999 në Teatrin Kombëtar

të Kosovës luajti në shfaqjet “Martesa e Barionit”, “Dredhëzat mbi varrë”, “Muzgu i lirisë” etj. Përveç në teatër, luajti edhe në serialet televizive vendore: “Autobusi”, “Buka e Kosovës”, “Kafeneja jonë” etj. (Naime Beqiraj)

AHMETI Ali (1959-). Veprihtar i lëvizjes kombëtare, pjesëmarrës i luftës në Kosovë, komandant dhe përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, lider i partisë Bashkimi Demokratik për Integrim. Lindi në fshatin Zajaz të Kërçovës (Maqedoni). Pasi kreu shkollën e mesme në Kërçovë, më 1979 filloi studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve 1981-



ALI AHMETI

1983 mori pjesë në lëvizjen studentore, për çka u arrestua dhe dënua me një vit burg. Në vitin 1986 mori strehim politik në Zvicër, ku veprroi si koordinator i grupeve të ndryshme politike të mërgimtarëve. Në vitet 1988/89 hyri ilegalisht në Kosovë dhe u bë njëri nga udhëheqësit e protestave të minatorëve dhe studentëve. Në vitet 1989/90 ishte njëri nga organizatorët e protestave masive të diasporës shqiptare nëpër Europë. Aktivitetin politik gjatë atyre viteve e zhvilloi në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Në vitin 1986 u zgjodh anëtar i këshillit të përgjithshëm, ndërsa në vitin 1988 u zgjodh anëtar i kryesisë së LPK-së, me detyrë në sektorin ushtarak. Në vitin 1996 u bë anëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në vitin 1998, në fillim të luftës, u zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në vitin 2001 u zgjodh komandant dhe përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Pas Marrëveshjes së Ohrit të nënshkruar në gusht dhe demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në shtator të atij viti, u angazhua në procesin e implementimit të kësaj marrëveshjeje. Në qershor të vitit 2002, me ish-bashkëluftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare themeloi partinë Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) dhe u zgjodh kryetar i kësaj partie. Në zgjedhjet e shtatorit të vitit 2002 të Maqedonisë u zgjodh deputet, ndërsa BDI-ja hyri në koalicionin qeveritar. Që nga ai vit ishte deputet i të gjitha përbërjeve parlamentare të Maqedonisë. (Fehari Ramadani)

AHMETI Ali (1961-). Mësimdhënës dhe veprimtar. Lindi në Preshevë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë (1984). Disa vjet ishte mësimdhënës në gjimnazin “Skënderbeu” në Preshevë. Për shkak të rezistencës ndaj ndërrimit të dhunshëm të emrit të shkollës nga autoritetet serbe, përjashtohet nga puna. Ishte anëtar i kryesisë së Kuvendit Komunal të Preshevës, themelues dhe kryetar i Shoqatës së Pavarur Demokratike në Preshevë, e cila më pas u shndërrua në Parti Demokratike Shqiptare me kryesi të njëjtë. Për shkaqe politike detyrohet të emigrojë në Gjermani, ku vazhdon të merret me aktivitet politik. U mor edhe me publicistikë. (Gafur Hyseni)

AHMETI Arben (1984-). Gazetar. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gazetari në Prishtinë. Punën e gazetarit e filloi në mediet lokale në Prizren, ndërsa në Prishtinë së pari punoi te gazeta e përjavshme “Java” e pastaj redaktor në të përditshmen “Iliria Post”. Për disa vjet punoi edhe në gazetën e përditshme “Kosova sot” dhe më pas edhe në gazetën tjetër të përditshme “Koha ditore”. Ka qenë edhe redaktor përgjegjës në gazetën “Tribuna”. Ishte kryetar i Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës në kohën kur kjo shoqatë organizoi protestën dhe grevën më të madhe të gazetarëve dhe medieve në Kosovë, lidhur me kundërshtimin e disa neneve kufizuese për medien në Kodi Penal të Kosovës. Është drejtor programi në Radiotelevizionin “Dukagjini”. (Artan Krasniqi)

AHMETI Burhan (1978-). Grafist. Lindi në Debresh të Gostivarit. Kreu shkollën e mesme në Gostivar, ndërsa studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve në Tetovë (2001). Grafikat e B. Ahmetit realizohen në shtypin e thellë, në teknikën e akuatintës dhe pasqyrojnë motivet e vendlindjes. Në vitet 2000-2004 punoi në Fakultetin e Arteve në Tetovë, në fillim demonstrator, më vonë asistent në drejtimin e grafikës. Nga viti 2006 u zgjodh asistent në Fakultetin e Pedagogjisë në “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup, ku më pas mori titullin docent. Mbajti një sërë ekspozitash personale, brenda e jashtë vendit, si në Galerinë “MC” në Nju-Jork (2012), në Galerinë “NU Koza”

në Dizhon, Francë (2010), në “Cite des Arts” Paris (2010), “Sudost” Berlin (2009), pastaj në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2009), në Galerinë e Muzeut të Shkupit, në “Studio e hapur e grafikës” po në Shkup, në Galerinë “Festa” në Sofje (2005), në Galerinë “Incontro” në Cyrih të Zvicrës etj. Ka marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive, bienale e triennale të grafikës dhe është fitues i një sërë çmimesh brenda e jashtë vendit. (Fatmir Krypa)

AHMETI Demë (sh. XIX). Veprimtar i çështjes kombëtare shqiptare. Lindi në Reçivcë të Mavriqit të Llapit. Familja e tij ishte ndër me të njohurat në rajonin e Llapit. Më 28 qershor të vitit 1811, bandat serbe në mënyrë të organizuar hynë në fshatin Mavriq dhe bënë masakër në familjen e D. Ahmetit, duke vrarë 28 anëtarë të kësaj familjeje. Serbët morën rob dy rejat dhe nipin e tij. D. Ahmeti i kishte shpëtuar masakrës. Me këtë rast, rreth 2,000 vullnetarë nga Llapi dhe Shala e Bajgorës i erdhën në ndihmë D. Ahmetit, kryengritësit kaluan kufirin dhe sulmuan forcat serbe në vendin e quajtur Polanë, afër fshatit të Shtavës, ku mbeten të vrarë një numër syresh. Kryengritësit arritën të shpëtonin dy rejat dhe nipin e D. Ahmetit. (Luan Tetaj)

AHMETI Hysni (1972-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Shupkoc të komunës së Mitrovicës. Përfundoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës i dy luftërave në ish-Jugosllavi: në Kroaci (1991-1992) dhe Bosnjë (1992-1998). Bënte pjesë në Gardën Shqiptare në Gospiq (Kroaci) dhe në Kotorr të Bosanski Brodit. Në nëntor të vitit 1993 u plagos në luftën e Bosnjës. Në maj të vitit 1998 u kthye në Kosovë me grupin e oficerëve shqiptarë, që kishin marrë pjesë në luftërat e Kroacisë dhe të Bosnjës. Ishte njëri nga themeluesit e Brigadës 141 “Mehë Uka” dhe më pas komandant i kësaj brigade të Zonës Operative të Shalës. Pas luftës kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në institucionet e Republikës së Kosovës. (Miftar Kurti)

AHMETI Isak (1946-). Shkrimtar, publicist. Lindi në Stubëll të Epërme të Vitisë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, në Viti dhe në Zhegër. Pas studimeve klasike në Kolegjin e Jezuitëve në Dubrovnik dhe në gjimnazin e

Gjilanit, studimet për filozofi dhe teologji i ndoqi në Kroaci. Më pas u diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Vitisë. Përmbledhjen e parë me poezi e botoi në vitin 1972, "Gallatea". Në vitet e mëpastajme botoi librat me poezi: "Uratë zbulimi" (1976), "Kushtimebesë" (1983), si dhe veprat monografike: "Kleri katolik shqiptar dhe letërsia" (1994), "Bibla në letërsinë shqiptare" (1999), "Letërsia kishtarë dhe filozofia e saj" (2000), "Kurani në letërsinë shqiptare" (2006) etj. U mor edhe me përkthime, kryesisht letrare, nga gjuha gjermane dhe italiane. Përktheu nga italishtja poezitë e Salvatore Quasimodos "Njeri i kohës sime" (1979) dhe nga gjermanishtja antologjinë e lirikës se re gjermane "Qumështi i zi i agimit" (1988) dhe përmbledhjen "Kohë e bardhë" (2000). (Munish Hyseni)

AHMETI Jahir (1963-). Mbledhës dhe studiues i folklorit. Lindi në Bërvenik të Podujevës. Kreu studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe (1986). Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare. Në vitin 1990 filloi punë në degën e folklorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Gjatë viteve 1997-2004 ishte sekretar shkencor i këtij instituti. Është pjesëmarrës me kumtesa në tubime shkencore dhe në ekspedita kërkimore në terren. Ka botuar recensione, punime studimore dhe monografinë studimore për këngët dhe lojërat popullore të fëmijëve. Është bashkëpërgatitës i disa vëllimeve të këngëve popullore të botuara nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. (Zymer U. Neziri)

AHMETI Lindita (1973-). Poete. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në Shkup, ndërsa studimet e larta për filologji klasike në Universitetin e Shkupit. Vjershat e saj



LINDITA AHMETI

janë botuar në faqet e revistave letrare në gjuhën shqipe në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. Me poezi u përfaqësua në shumë antologji në gjuhën shqipe, maqedonase dhe në gjuhë të tjera. Botoi pesë përmbledhje me poezi: "Mjedra dhe bluz" (1993), "Ishulli Adular" (1996), "Brezi i Zonjës" (2000), "Vetë përballë Erosit"

(2004); "Lulja Alba" (përzgjedhje, 2008). Pothuaj të gjitha librat e saj u përkthyen në gjuhën maqedonase, kurse njëri edhe në gjuhën bullgare. Në vitin 1993 mori çmimin për librin më të mirë në gjuhën shqipe në Maqedoni, "Mjedra e bluz". Është fituese e çmimit "Qiriu i Naimit" për vjershën më të mirë në Festivalin e parë poetik "Ditët e Naimit" në Tetovë. Në vitin 2013 e mori çmimin e parë për poezi në konkursin letrar të komunës së Tetovës. (Fatmir Sulejmani)

AHMETI Malush (1951-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Rezallë të komunës së Skënderajt. Bënte pjesë në grupin e parë të luftëtarëve të UÇK-së në Zonën Operative të Drenicës. Pas daljes publike të UÇK-së, shtëpia e tij u bë bazë e përhershme e luftëtarëve. Bënte pjesë në batalionin e parë të Brigadës 113 "Mujë Krasniqi", zona e përgjegjësisë e së cilës shtrihej në territorin e fshatrave: Rezallë, Marinë, Makërma, Polluzhë, dhe Kryshec. Më pas, në nëntor të vitit 1988 u caktua epror në Zonën Operative të Drenicës dhe mori pjesë në luftimet që u zhvilluan edhe në Jashanicë, pastaj në vijën e frontit në përforcime të Zonës Operative të Shalës. Ra më 15 maj 1999 në malin e Paluhit, në Brigjet e Rezallës, nga predhat e minahedhësve të armikut. (Skënder Lutfiu)

AHMETI Muhamet (1961-). Dizajner. Lindi në Ferizaj. Shkollimin bazë e mori në Ferizaj, ndërsa studimet për dizajn grafik i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1985). Hapi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive brenda e jashtë vendit dhe mori disa çmime për krijimtarinë artistike. Botoi një numër të madh ilustrimesh, posterësh, karikaturash tematike në libra, revista dhe gazeta të ndryshme. Ishte kryetar i Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës dhe udhëhoqi dy aktivitete kulturore të karakterit ndërkombëtar: "Euro Kosova Art" dhe "Gara e artit global". Punon si ekspert lëndor në Ministrinë e Arsimit dhe është autor i tre teksteve shkollore për artet figurative dhe bashkautor i teksteve për tri nivele të mësimin në diasporë. Punon si mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Zeni Balazhi)

AHMETI Osman (1975-). Aktor. Lindi në Llojan të Kumanovës. Shkollën fillore e kreu

në vendlindje, të mesmen në Preshevë. Kreu studimet për aktrim më 1997 në Fakultetin e Artit Skenik në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë. Realizoi disa role në teatër dhe në film, nga të cilët mund të veçohen: “Vdekja e Dantonit”, “Gof”, “Një burrë me dy gra”, “Repriza e Iirisë”, “Nata e dymbëdhjetë”, “Vdekja aksidentale e një anarkisti”, “Fany Many”, “Vojceku”, “Kurthi i vdekjes”, “Kthesa”, “Arseniku dhe dantelat e vjetra” etj. Luajti edhe në filmat “Ne dhe Lenini”, “Lindje-Perëndim-Lindje”, “Ballkoni” etj. Është themelues dhe botues i revistës mujore për kulturë “Alternativa” (2003), themelues i Teatrit të pavaruar “Subcult” (2008) dhe bashkëthemelues i Festivalit të Teatrit “Skupifestival” (2007). Nga viti 2006 është anëtar i ansamblit të Teatrit Shqiptar të Shkupit. (Kushtrim Bekteshi)

AHMETI Salih (1957-). Mjek, infektolog, profesor universiteti. Lindi në Molliq të Gjakovës. Mbaroi arsimin fillor në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Deçan. Kreu studimet në



SALIH AHMETI

Fakultetin e Mjekësisë të UP-së, kurse specializimin nga infektologjia e përfundoi në Zagreb (1987). Në Universitetin e Zagrebit mbaroi dhe subspecializimin për laparoskopji dhe ultrasonografi. Vijoi studimet pasuniversitare po në Universitetin e Zagrebit, por u magjistrua në Prishtinë. Mbrojti Tezën e doktoratës nga fusha e epidemiologjisë (1993) në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (UP). U zgjodh asistent i infektologjisë (1988) dhe më pas mori të gjithë titujt universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar në vitin 2004. Gjatë viteve ’90 punoi si vullnetar në Poliklinikën “Nënë Terëza” në Prishtinë. Është bashkautor i doracakut “AIDS-SIDA sëmundje që vret” (1998). Pas luftës ushtroi funksione të ndryshme në institucionet shëndetësore dhe të arsimit të lartë. Ishte drejtor i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, drejtor i Klinikës Infektive, dekan i Fakultetit të Mjekësisë etj. Mori pjesë në simpoziume e kongrese shkencore dhe botoi në revista vendore dhe ndërkombëtare. (Muharrem Bajrami)

AHMETI Selatin (1936-2001). Piktur, ilustrator. Lindi në Podujevë. Mbaroi shkollimin

fillor në Podujevë, ndërsa ishte nxënës i brezit të parë në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Kreu Akademinë e Arteve në Prishtinë. Në fillim punoi në shkollën fillore “Meto Bajraktari” në Prishtinë dhe më vonë në gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Më pas për shumë vjet punoi në gjimnazin “8 Nëntori” në Podujevë. Së fundi kaloi në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore në Prishtinë, ku bëri ilustrimin e shumë teksteve shkollore dhe librave për fëmijë. Për punën e frytshme dhe cilësore mori disa çmime dhe mirënjohje. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës që nga themelimi dhe, në kuadër të saj, mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. (Bislim Aliu)

AHMETI Shemsi (1969-1999). Ushtarak, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Kodër (ish-Zasellë) të Mitrovicës. Kreu Shkollën e Mesme Ushtarake në Beograd dhe në Sarajevë. Më pas vazhdoi studimet në Akademinë e Ushtarake të Artilerisë në Zarë të Kroacisë. Ishte pjesëmarrës i luftës kroato-serbe në Knin dhe Vukovar. Në qershor të vitit 1998 u inkuadrua në radhët e Brigadës 141 “Mehë Uka” të Zonës Operative të Shalës. Në janar të vitit 1999 nga komanda e Brigadës u emërua komandant i njësisë speciale. Një muaj më vonë themeloi njësitin e artilerisë. Ishte edhe komandant i kazermës ushtarake në fshatin Bare dhe koordinatori i sulmeve të shumta kundër njësiteve ushtarake serbe në rajonin e Shalës së Bajgorës. Në prill 1999 mori pjesë në sulmin kundër bazës ushtarake serbe në Kutlloc, duke i detyruar forcat serbe të tërhiqen. Mori pjesë në betejën e Trepçalivë, të Mazhiqit, të Rahovës, të Majdanit etj. Ra heroikisht në betejën e Majdanit më 26 prill 1999. Në vitin 2012 presidentja e Republikës së Kosovës e dekoroi me Urdhryn “Hero i Kosovës”. (Miftar Kurti)

AHMETI Myderriz Sherif (1920-1998). Teolog islam, përkthyes i Kuranit, veteran i arsimit. Lindi në Gumnasellë të Lipjanit. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas i vazhdoi në Medresenë e Ferizajt dhe të Prizrenit, ndërsa u diplomua në Medresenë “Pirinaz” të Prishtinës (1944). Pas Luftës së Dytë Botërore ndoqi kursin pedagogjik në Prizren e Pejë dhe punoi si mësues në fshatrat Banullë, Gadime dhe Sllovi. Më 1956 u emërua imam në Xhaminë e fshatit

MYDERRIZ
SHERIF AHMETI

Glligoc të Lipjanit ndër-
sa më 1965 u caktua
pedagog në Medresenë
e Mesme “Alaudin” të
Prishtinës, ku ligjëroi
lëndët apologetikë dhe
filozofi islame. Ishte dre-
jtor i Medresesë (1970-
1984) dhe më 1985 u
emërua myfti i Prishti-
nës, detyrë që e kreu deri në pension (1990).
Me themelimin e Fakultetit të Studimeve Is-
lame në Prishtinë (1992) u angazhua ligjërues i
lëndës së apologetikës islame. Ishte themelues
dhe drejtues i periodikut islam në gjuhën shq-
ipe në Kosovë: “Buletini informativ” (1968),
“Takvimi/Kalendari” (1970), “Edukata islame”
(1971) dhe autor i një sërë shkrimesh nga fu-
sha e apologetikës islame dhe islamologjia.
Ishte përkthyesi dhe komentuesi më i shquar
i Kur’anit në gjuhën shqipe (“Kur’ani përkthim
me komentim”, 1998). (Ramadan Shkodra)

AHMETI Xhabir (1945-). Tregimtar, roman-
cier, dramaturg. Lindi në Përshefcë të Tetovës.
Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në
Tearcë, gjimnazin në Tetovë, studimet për gjuhë



XHABIR AHMETI

e letërsi shqipe në Priz-
ren, Prishtinë e Shkup.
Një kohë punoi si mësues
në Shemshovë të Tetovës,
pastaj në Bllacë e Duhël
të Suharekës, mësimdhë-
nës në Normalen e Priz-
renit. Më vonë u punë-
sua si gazetar në “Flaka
e vëllazërimit” në Shkup.
Disa vjet ishte korrespondent i “Rilindjes” nga
Shkupi. Punoi edhe në Bibliotekën Universi-
tare në Shkup. Pak kohë ishte zëvendës-drejtor
i Radiotelevizionit të Maqedonisë. Është ide-
atori dhe themeluesi i Institutit për Trashëgimi
Kulturor të Shqiptarëve në Shkup. Në letërsi u
paraqit me tregime të botuara në faqet e shtypit
shqiptar. Pasojnë romani “U kthye përsëri”
(1977), “Dy drama” (1979), përmbledhjet me
tregime “Degët e një druri” (1982) dhe “Përveç
fjalëve të këngës” (1989) dhe romani “Lule në
tjegulla” (1984). U mor edhe me përkthime
nga maqedonishtja e serbishtja në shqip dhe
anasjelltas (mbi njëzet vepra). Në vitin 2012
e përktheu në shqip përmbledhjen e këngëve
popullore maqedonase e bullgare të vëllezërve
Miladinov. (Fatmir Sulejmani)

AHMETI Xhavit (1952-1996). Kimist, profe-
sor universiteti. Lindi në Përlepnice të Gjila-
nit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje,
ndërsa Normalen në Gjilan. Në vitin 1975 kreu



XHAVIT AHMETI

studimet për kimi në
Fakultetin e Shkencave
Matematike-Natyrore
(FSHMN) të Univer-
sitetit të Prishtinës
(UP). Studimet pasuni-
versitare dhe tezën e
disertacionit e mbrojti
në FSHMN të Univer-
sitetit të Zagrebit (1985).
Zgjidhet asistent i kimisë në FSHMN të UP-
së (1975) dhe më pastaj profesor asistent dhe
profesor i asociuar. Vdiq në moshë të re në
aksident trafiku. Publikoi punime në revista
shkencore dhe mori pjesë me kumtesa në tu-
bime shkencore, projekte etj. Është bashkautor
i tekstit universitar “Kimia fizike eksperimentale”
(Nexhat Daci)

AHTISARI (Ahtisaari) Marti (1937-). Poli-
tikan finlandez, ndërmjetës në zgjidhje kon-
testesh ndërkombëtare, laureat i çmimit Nobel
për Paqe. Prej vitit 1994 deri më 2000 shërbeu



MARTI AHTISARI

si presidenti i dhjetë
i Finlandës. Gjatë fu-
shatës ajrore të NATO-s
në vitin 1999 negocioi,
bashkë me të deleguarin
e Federatës Ruse, Vik-
tor Çernomirdin, me
presidentin e Serbisë
Slobodan Millosheviq.
Në vitin 2006 u emërua
Përfaqësues i Posaçëm i Sekretarit të Përgjith-
shëm të OKB-së në procesin e zgjidhjes së
statusit të Kosovës. Udhëhoqi negociatat ndër-
mjet Kosovës dhe Serbisë gjatë viteve 2005-
2007. Për angazhimin e tij në zgjidhje të një
numri kontestesh ndërkombëtare, si në Nami-
bi, Aceh-Indonezi, Kosovë e Irak, në vitin 2008
u nderuar me çmimin Nobel për Paqe. Më pas
drejtoi “Nismën për menaxhim të krizave”, e
njohur edhe si “Qendra Marti Ahtisari”, orga-
nizatë që angazhohet për parandalimin dhe
zgjidhjen e konflikteve, si dhe për paqe të qën-
drueshme në botë. (Ilir Dugolli)

AIIESEE (ANSEJL). Asociacionini Ndër-
kombëtar i Studimeve të Europës Juglindore. U

themelua më 1963 në Rumani, me mbështetjen e UNESCO-s dhe e ka selinë e sekretariatit të përgjithshëm në Bukuresht. Asociacioni i themeluar si institucion joqeveritar synon promovimin e studimeve të qytetërimeve të shpërndara në hapësirat e Ballkanit dhe të Europës Juglindore përgjithësisht si dhe të marrëdhënieve me qytetërime të tjera të Europës dhe të botës. Sekretar i përgjithshëm i AIESEE-së është Rëzvan (Răzvan) Teodoresku. Komiteti i Kosovës i Studimeve të Europës Juglindore është pranuar anëtar me të drejta të plota i AIESEE-së në Kongresin e mbajtur në Sofje më 2015. (Bardh Rugova)

AJAZAJ Hamdi (1947-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Zhur të Prizrenit, shkollën fillore dhe gjimnazin i mbaroi në Prizren, studimet i kreu në degën e fizikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) më 1970. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit. U zgjodh asistent në katedrën e fizikës të FSHMN-së të UP-së (1973). Tezën e disertacionit e mbrojti po në këtë katedër, nga lëmi i fizikës bërthamore. Për aftësim shkencor profesional ka qëndruar në disa universitete jashtë vendit. Hulumtimet e tij shkencore kanë të bëjnë me strukturën bërthamore, reaksionet bërthamore, simetritë në fizikën e grimcave elementare dhe bërthamore, teorinë e solitoneve në fizikën e grimcave elementare dhe të gjendjes së ngurtë. Ka botuar disa punime shkencore, tekste të fizikës për shkolla të mesme dhe tekste universitare (“Ushtrime të zgjidhura të mekanikës kuantike”). (Zahadin Shemsedini)

AJAZAJ Riat (1969). Shkrimtar. Lindi në fshatin Zhur të Prizrenit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, kurse të mesmen në Prizren, studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe dhe drejtësinë në Universitetin e Prishtinës. Në vitet '90 emigroi në Gjermani dhe i vijoi studimet për letërsi të krahasuar në Universitetin e Tübingenit në Gjermani. Në vitin 2007 u doktorua në drejtimin letërsi ndërkombëtare po në këtë universitet me temën “Paraqitja e diktaturës te Asturias, Carpentier dhe Kadare”. Punon si mësues gjimnazi në Shtutgard të Gjermanisë. R. Ajazaj ka botuar librat e poezisë: “Gryka e Lumës” (1992), “Në perëndim bie shi” (1995), “Pëshpërimat e mureve”

(2000); librat e tregimeve: “Zanfina” (2001), “Gjarpërinjtë e ëndrrës” (2003); romanet; “Arkëmorti bosh” (2003), “Ndanë” (2004). Në gjermanisht ka botuar librat: “Valixhja” (Der Koffer, 2007), “Marxhana” (Mardschana, 2009), “Yaku” (2015) dhe “Shelgu vajtues” (Trauerweide, 2015). (Shaip Beqiri)

AJDINI Burim (1980-). Piktur. Lindi në Tetovë. Shkollimin bazë e mori në vendlindje. Kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Që nga viti 1999 punon si mësues në artit figurativ në shkollën e mesme “Moshë Pijade” në Tetovë. I takon brezit të ri të krijuesve të artit pamor, i cili në veprat e tij e trajton peizazhin në mënyrë ekspresive. Është pjesëmarrës i disa ekspozitave kolektive. Ka realizuar ekspozitë personale në Qendrën Kulturorë Informativë në Shkup, në “Cite international des art” në Paris, në Pallatin e Kulturës në Tetovë, në “Galeria 8”, Bezistan të Shkupit etj. (Jëldeze Asani)

AJDINI Qemal (1935-1979). Aktor, dramaturg, regjisor, përkthyes. Lindi në Zerqan të Dibërës (Shqipëri). Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Dibër të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Studimet për punë sociale i kreu më 1963 në Universitetin e Shkupit. Krijimtarinë artistike si aktor e filloi më 1953 në Teatrin e Kombësive (Drama Shqipe). Luajti shumë role në shfaqje të ndryshme



QEMAL AJDINI

teatrore, të cilat ishin kryesisht pjesë e repertorit të këtij teatri, ndër të cilat më të shquar ishin: “Lavirja e denjë për respekt”, “E çka tash Keron”, “Vjedhja pas mesnate”, “Daja Vanja”, “Varret e pafajshme”, “E ikura”, “Kënga”, “Ëndrra e një nate vere” etj. Po ashtu luajti një sërë rolesh në radiodramat e realizuara në Radio-Prishtinë dhe Radio-Shkupi, si dhe disa role në drama dhe seriale televizive (“Era dhe lisi” etj.). Është autor dhe regjisor i disa radiodramave, si dhe bashkautor i dramës “Varret e pafajshme” (1971). Përveç punës në teatër, radio dhe TV kontribuoi edhe në zhvillimet kulturore në Dibër, duke ndihmuar grupet teatrore amatore të këtij qyteti në realizimin e shfaqjes “Besa” (1962) “Matura” (1975). Përktheu edhe disa

drama, të cilat u inskenuan në Teatrin e Kombësive (Drama Shqipe) në Shkup. (Kushtrim Bekteshi)

AJDINI Teuta (1963-). Aktore. Lindi në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Shkup, ku kreu edhe Fakultetin e Artit Dramatik (1986). Në periudhën 1986-1988 ishte pjesë e ansamblit të Teatrit të Kombësive në Shkup (Drama Shqipe), ndërsa në vitet 1988-1993 punoi në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë. Më 1993 u rikthye në Teatrin e Kombësive. Luajti një sërë rolesh në shfaqje të ndryshme, ndër të cilat: “Shi në Uertomonto”, “Sauna” “Varreza e automobilave”, “Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit”, “Mbreti Lir”, “Antigona”, “Kishte dy pistoleta me sy të bardhë”, “Eshtrat që vijnë vonë”, “Edipi mbret”, “Vdekja dhe virgjëresha”, “Shi në plazh”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Shtëpi në erë”, “Makbethi” etj. Luajti rolin e nuses në filmin “Njeriu prej dheu” të Agim Sopit, si dhe në disa filma dhe drama televizive (“Migjeni”, “Babai”, “Librat e babait”), si dhe në serialin televiziv “Mëhalla jonë”. U nderua me shumë çmime në festivale të ndryshme në Maqedoni dhe në Kosovë: çmimi për realizim më të mirë artistik në Festivalin e Teatros së Maqedonisë “Vojdan Çernodrinski” (1988), çmimi për aktoren më të mirë në Festivalin e Teatrit Shqiptar në Dibër (2004), çmimi për aktoren më të mirë në Festivalin “Talia e Flakës” në Gjilan (2013) dhe çmimi për aktoren më të mirë në rol dytësor në Festivalin Teatror të Ferizajt (2014). Në vitet 1999-2002 punoi si asistente në katedrën e aktrimit me mësim në gjuhën shqipe në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup. (Kushtrim Bekteshi)



TEUTA AJDINI

AJETI Bardhyl (1977-2005). Gazetar. Lindi në fshatin Përlepnicë të komunës së Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Punën e gazetarit e nisi në vitin 2000, fillimisht si korrespondent i gazetës “Bota sot” nga Gjilani e më pas edhe gazetar dhe kolumnist i kësaj gazete. Shkrimet e tij, sidomos në vitet 2002-2004, kishin gjuhë kritike ndaj liderëve dhe ngjarjeve politike. Ndaj tij u bë atentat më 5 qershor të vitit 2005 në hyrje të Gjilanit, ndërsa

vdiq më 28 qershor 2005 në Milano të Italisë, ku ishte dërguar për mjekim. (Veli Bytyçi)

AJETI Gani (1934-2015). Gazetar i sportit. Shkrimet e para i botoi në gazetën e përditshme “Rilindja” në vitin 1958. Raportoi në kampionate botërore, lojëra olimpike verore e dimërore. Më vonë, me raportet e tij në Televizionin e Prishtinës, e veçmas me emisione dokumentare, u dëshmuua për angazhime sportive e bashkëkohore. U shqua edhe si punëtor i sportit: ishte kryetar i Lidhjes së Futbollit të Kosovës, nënkryetar i Lidhjes së Futbollit të Jugosllavisë (1971), anëtar i Komitetit Ballkanik të Futbollit dhe anëtar i Komisionit të të rinjve të futbollit të UEFA-s (1972). Arriti të formojë në Kosovë Ligën e Juniorëve, e vetmja e tillë asokohe në Europë. Në vitin 1974 ishte anëtar i komitetit të organizimit të Kampionatit Botëror të Futbollit, i cili u mbajt në Gjermani. Botoi librat “Besa-besë e futbollit të Prishtinës”, “Liria dhe futbollit” dhe “Pavarësia dhe futbollit”. Në vitin 1996 nxori gazetën sportive javore “Sport plus”. (Baki Berisha)

AJETI Idriz (1917-). Gjuhëtar, albanolog, akademik. Ndër gjuhëtarët pionierë të Kosovës, themelues dhe drejtues i revistave dhe institucioneve albanologjike në Kosovë, kryetar



IDRIZ AJETI

i Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve paralele më 1998, pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë më 1999. Lindi në Tupallë të Medvegjës. Shkollën e mesme (Medresenë e Madhe) i ka kryer në Shkup, studimet për gjuhësi i ka nisur në Zagreb, më pas në Padovë, tek albanologu K. Taljavini, ndërsa diplomoi për romanistikë në Beograd (1949), tek albanologu H. Bariq. Ka punuar si profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në gjimnazin e Prishtinës (1949-1953), lektor në degën e albanologjisë të Fakultetit të Filozofisë të Beogradit (1953-1960), ku më 1958 mbrojti disertacionin e doktoratës me temën: “Zhvillimi historik i të folmes geqe të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë”. Nga themelimi, më 1960, për njëzet vjet me radhë, e ka drejtuar katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin

Filozofik të Prishtinës, ku ka mbajtur lëndët histori e gjuhës shqipe dhe dialektologji. Ka qenë drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës në vitet 1970-1972 dhe 1983-1986 dhe themelues i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (Prishtinë, 1974), të cilin e ka drejtuar deri më 1991. I ka drejtuar revistat “Gjurmime albanologjike”, “Recherch albanologiques”, “Studia humanistica”, “Studime” etj. Gjatë viteve 1971-1973 ka qenë dekan i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitet vijuese rektor i këtij universiteti. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) që nga themelimi dhe kryetar në dy mandate (1979-1981 dhe 1996-1999). Fushat kryesore të studimeve shkencore të I. Ajetit janë: dialektologjia historike dhe e sotme e gjuhës shqipe, historia e gjuhës shqipe, fonetika dhe morfologjia historike, filologjia, etimologjia, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët sllave të Ballkanit, historia e shqipes letrare dhe çështje të normës letrare e të kulturës së gjuhës. Ka marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë për normimin e shqipes letrare në Kosovë (1952, 1957, 1963) dhe më 1968 e ka mbajtur referatin kryesor në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, duke mbështetur konvergjencën e normës letrare. Ka dhënë kontribut për organizmin dhe mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972). Vepra shkencore e tij përbëhet nga studime monografike, nga trajtesa të veçanta dhe artikuj shkencorë për çështje të ndryshme të gjuhës shqipe. Ndihej të rëndësishme ka dhënë në fushën e ndikimit të shqipes në të folmet sllave të jugut, në fushën e studimeve të dialektologjisë historike, në proceset e vendimmarrjes për standardizimin e shqipes etj. I rëndësishëm ka qenë kontributi i tij për zhvillimin e studimeve albanologjike në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Vepra e tij shkencore është botuar nga ASHAK-u (1998-2002) e përmbledhur në pesë vëllime (“Studime gjuhësore në fushë të shqipes I-V), ku janë përfshirë edhe studimet e hershme dhe kontributet e mëvonshme, si: “Pamje historike e ligjëritimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX”, “Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë”, “Hymje në historinë e gjuhës shqipe”, “Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike)”, ndërsa një numër artikujsh shkencorë, që shtrojnë çështje të ndryshme të

aktualitetit gjuhësor shqiptar janë përfshirë në veprat “Shqiptarët dhe gjuha e tyre” (1994) dhe “Për të vërtetën shkencore” (2006). Akademia e Shkencave e Shqipërisë ia botoi vëllimin “Studime dialektore dhe etimologjike” (2005), ndërsa më 2012 nga shtëpia botuese “Koha” u botua përmbledhja “Pararendësi”. Është laureat i Çmimit të AVNOJ-it (KAÇKJ), anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave, ndërsa Presidenti i Shqipërisë e ka shpallur “Nder i kombit”. (Bardh Rugova)

AJETI Melihate (1935-2005). Aktore. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe semimaturën i kreu në vendlindje. Më pas kreu shkollën e aktrimit, e cila më 1952 ishte hapur në kuadër të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Ishte njëra nga aktoret e para të Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Për më shumë se 50 vjet krijoi një gamë të gjerë prej mbi 80 rolesh në shfaqje të ndryshme.



MELIHATE AJETI

Luajti kryesisht në rolet kryesore. Në vitet '50 dhe '60 luajti në shfaqjet: “Deputeti i popullit”, “Zullumqari”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Sikur të isha djalë”, “Besë” (Merushja), “Zonja ministreshë” etj., ndërsa më pas luajti në shfaqjet: “Zonja me kamelië”, “Tartufi”, “Nuk martohem me pare”, “Erveheja”, “Othello”, “Antigona”, “Halili e Hajrija” etj. Në vitet '70 vazhdoi të luante në shfaqjet e inskenuara në Teatrin Krahinor: “Mbreti Edip”, “Kaligula”, “Të ngjuarrit”, “Dasma e përgjakur”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Revizori”, “Shtetrrethimi”, “Makbethi”, “Sfinga e gjallë”, “Genci” etj. Role të rëndësishme luajti edhe në shfaqjet e inskenuara më vonë, si “Vdekja e një mbretëreshë”, “Hamleti”, “Varri i qyqes”, “Confiteori”, “Nëna shkon në parajsë” etj. Edhe pas vitit 1999 kishte angazhime të herëpashershme të Teatrit Kombëtar të Kosovës, si në shfaqjet “Hamleti”, “Ëndrra e qenit”, dhe “Shfaqja e fundit”. Krahas teatrit, luajti edhe në disa filma, drama televizive dhe në seriale filmike: “Uka i Bjeshkëve të Nemuna”, “Buka”, “Etja”, “Trimi”, “Lepuri me pesë këmbë”, “Era dhe Lisi”, “Kur pranvera vonohet”, “Të ngjuarrit”, “E shtëna në ajër”, “Përroi vërshues”, “Migjeni”, “Gjurmet e bardha”, “Dorotej” etj. U

nderua me mirënjohje dhe çmime të ndryshme nga institucionet lokale dhe qendrore të ish-Jugosllavisë, nga shoqatat profesionale, pastaj në festivale të ndryshme, kryesisht për kreacionet dhe rolet më të mira të femrës në shfaqjet “Zonja me kamelië”, “Erveheja”, “Halili dhe Hajrija”. Më 1979, në Festivalin e Filmit në Nish (Serbi), për rolin e saj në filmin “Kur pranvera vonohet” u nderua me çmimin për rolin më të mirë episodik. (Bekim Lumi)

AJGERAJ Gëzim (1967-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Malësi e Vërrinit (ish-Lubiçevë) të Prizrenit. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmet në Prizren. Shkruan poezi për fëmijë dhe për të rritur, pastaj tregime, novela, romane, monografi, shkrime publicistike, kritikë letrare, ese, dramë, monografi etj. Qysh i ri ka emigruar në Zvicër. Krijimet e veta letrare për fëmijë dhe për të rritur i ka botuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme në Kosovë, Zvicër, Shqipëri dhe Maqedoni. Nga viti 1997 botoi shumë vepra letrare zhanresh të ndryshme, ndër to vëllimet me poezi: “Ëndrra për parajsë” (1998) dhe “Nxitoj të kthehem me dritë” (2013), pastaj romanet “Misioni i kriminelit” (2008) dhe “Studentët” (2014), novelën “Shtigjet e bardha” (2014), dramën “Rruga e lirisë” (2001) dhe monografinë “Xhevat Berisha-legjenda e Vërrinit” (2013) etj. Jeton në Zvicër. (Hasan Hasani)

AJRULI Ekrem (1957-). Poet, gazetar. Lindi në fshatin Sellarcë e Epërme të Tetovës, ku kreu shkollën fillore, kurse të mesmen në Tetovë. Është autor i librave me poezi: “Marshi i demonëve” (1995), “Rroftë e qoftë Lolestani” (2004), “Kur qesh doktor Valuta” (2007), “Palopatriotët” (2012). Është autor edhe i librit me tregime “Oaza e rriqrave” (2013). Është pjesëmarrës në manifestime të ndryshme letrare, ndërsa poezitë e tij janë botuar në revista të ndryshme në gjuhën shqipe dhe boshnjake. Shkruan kryesisht poezi sarkastike. (Salajdin Salihu)

AJVAZI Bajram (1898-1960). Veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi në Peran të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Bradash. Që nga viti 1913 u mor me tregti. Gjatë Luftës së Parë Botërore ishte në *çetën e Ramë Vllasës*. Më 1918 kundërshtoi okupimin serb dhe më pas anëtarësohet në partinë “Xhemijet” dhe në Komitetin e Kosovës. Më 1920 detyrohet të

emigrojë për në Turqi, por pas një kohe kthehet që andej bashkë me 83 familje kosovare. Më 1935 u zgjodh kryetar komune në Podujevë dhe deri më 1940 ndërtoi 37 shtëpi për muhaxhirë që ktheheshin nga Turqia. Pas Luftës së Dytë Botërore (1948) burgoset për veprimtari politike, ndërsa më 1949 i konfiskohet tërë pasuria në Prishtinë dhe në Podujevë. Më 1952 vendoset në Peran dhe fillon të merret me bujqësi. Gjatë viteve 1953-1958 u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. (Hakif Bajrami)

AJVAZI Fehmi (1962-). Gazetar. Lindi në Gjilan, ku kreu gjimnazin, kurse më pas studioi për drejtësi dhe shkencë politike në Universitetin e Prishtinës (UP). Me shkrime filloi të merret në fund të viteve '80, duke bashkëpunuar me gazeta dhe revista të ndryshme të kohës. Punën e gazetarit e filloi në vitin 1998, në gazetën e studentëve të UP-së “Bota e re”. Për afro 20 vjet ka punuar në revista dhe gazeta të përditshme. Krahas gazetarisë është marrë edhe me krijimtari letrare. Ka botuar disa libra me poezi dhe publicistikë: “Porta e hapur” (1995), “Vite të stuhishme” (1996), “Spiritus” (2007) etj. (Nehat Islami)

AJVAZI Shemsi (1941-). Historian, mësimdhënës universitar. Lindi në Peran të Podujevës. Mbaroi shkollimin fillor në Gjakovë, Medresenë e ulët në Prishtinë, ndërsa në Sarajevë Medresenë e Gazi Husrev-beut. Kreu studimet në Universitetin e Bengazit (Libi), në Fakultetin e Gjuhës Arabe dhe të Shkencave Islamike, në degën e së drejtës së shariatit dhe të jurisprudencës. Përfundoi studimet pasuniversitare nga historia në Universitetin e Prishtinës. Në periudhën 1975-1978 punoi si bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Historisë së Kosovës dhe më pas ligjërues i gjuhës arabe në degën e orientalistikës të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1978-1992). Pas mbylljes së dhunshme të Universitetit të Prishtinës, u punësua në Libi, në Akademinë e Studimeve Pasuniversitare, si ligjërues i së drejtës krahasimtare të shariatit dhe të jurisprudencës bashkëkohore (1993-1998). Me kumtesa mori pjesë në një sërë konferencash shkencore. Ka përkthyer disa vepra letrare nga gjuha arabe, si dhe është autor i monografisë “Gjeopolitika” (2009). (Hatixhe Ahmedi)

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE. U themelua nga OSBE-ja në vitin 1999 në Vushtrri, si trashëgimtare e shkollës së mesme të policisë, që punoi nga viti 1974. Në fillim u quajt Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës, në viti 2006 u bë Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, ndërsa nga viti 2008 quhet Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Është institucion i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili ofron shërbime profesionale të cilësisë së lartë të arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit për agjencitë e sigurisë publike në Republikën e Kosovës, siç janë: Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe Inspektorati Policor i Kosovës. (Demë Hoti)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS (ASHAK) (Arkitektura). Projektues të objektit janë arkitektët kosovarë A. Loxha dhe M. Haziri, ndërsa dokumentacionin projektues e përgatiti firma “ADE” nga Peja në vitin 2005. Realizimin e punëve ndërtimore e bëri firma kosovare “Altrade” nga Prishtina. Përrurimi i ndërtesës u bë më 15 janar të vitit 2010. Me një arkitekturë bashkëkohore, objekti ka sipërfaqe rreth 4,800 m² mbi tokë dhe etazhitet 2B+P+NK. Me projekt është paraparë garazhi nën nivelin e tokës (në dy bodrume), sipërfaqe e destinuar për qëllime vetanake të institucionit si dhe për qasje publike të qytetarëve. Përmbajtjet dhe organizimi i brendshëm i objektit plotësojnë nevojat e veprimtarisë së ASHAK-ut, përmes organizimit të hapësirave të kryesisë, seksioneve, hapësirave të administratës, sallës për simpoziume shkencore, sallës për Kuvendin e Akademisë me 100 vende, sallës për kryesinë e Akademisë, sallës për ekspozita të përhershme, hapësira e bibliotekës për 300,000 libra, instituteve/qendrave studimore të Akademisë, kabineteve dhe hapësirës së arkivit. Struktura e objektit është dominuese në rrethinë jo vetëm për nga vëllimi, por edhe për nga përdorimi i materialeve të teknologjisë së kohës. Trajtimi i mbështjellësit të jashtëm me fasadë strukturale të kombinuar me pllaka të terakotës si dhe përfundimi i mbulesës së kulmit të objektit me një formë ekstravagante të mbështjellë me material të plumbit e bëjnë objektin të cilësohet me arkitekturë bashkëkohore. (Vlora Navakazi)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS (ASHAK). Institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Kosovë, me seli në Prishtinë, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Është institucion i mëvetësishëm në fushën e shkencës dhe të artit. Veprimtaria e saj është me interes të veçantë publik e kombëtar, qëllimi i së cilës është zhvillimi dhe nxitja e punës kërkimore-shkencore dhe artistike në Kosovë, përkujdesja për zbatimin e arritjeve shkencore dhe për kultivimin e vlerave artistike në vend, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit shkencor dhe artistik ndërkombëtar. Pararendëse e Akademisë ishte Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, themeluar më 20 dhjetor 1975, e cila në fund të vitit 1976 u pranua në Këshillin e Akademive të Shkencave dhe të Arteve të ish-Jugosllavisë. Me Ligjin mbi Themelimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 18 prill 1978, kjo Shoqatë u shndërrua në Akademi të Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Periudha prej themelimit të saj deri në vitin 1992 shquhet nga përpjekjet për konsolidimin e veprimtarisë së saj shkencore dhe artistike në kuadër të Jugosllavisë. Fillimisht kishte tri seksione: të shkencave shoqërore, të shkencave të natyrës dhe të gjuhës, të letërsisë e të arteve. Në këtë periudhë filloi edhe veprimtaria e saj shkencore dhe artistike, duke përfshirë edhe botimet e para periodike dhe botimet e veçanta të anëtarëve të saj. Në fillim të viteve '90 veprimtaria e këtij

institucioni shkon duke u vështirësuar. Në vitin 1992, Kuvendi i Serbisë, përmes Ligjit për Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, e ndaloi përfundimisht veprimtarinë e këtij institucioni. Në këto rrethana, ASHAK-u u detyrua ta zhvillojë veprimtarinë e saj në një objekt privat, e ndihmuar prej donatorëve të ndryshëm. Ndonëse në kushte shumë të vështira, në vitin 1994 filloi një ringjallje e veprimtarisë së saj, me revista të reja dhe me një sërë botimesh të veçanta. Ndërkohë, u krijua edhe seksioni i arteve. Kjo fazë përfundoi me çlirimin e Kosovës (1999), duke nisur njëkohësisht faza e re e zhvillimit të institucionit dhe e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike e Akademisë, me aktivitete dhe botime të reja më cilësore, me anëtarë të rinj etj. Në janar të vitit 2011 Akademia u vendos në objekt të ri. Veprimtaria e ASHAK-ut mbështetet në Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës (2004, plotësuar më 2016), në Statutin e saj dhe në rregulloret përkatëse. Sipas këtij ligji, Akademia përbëhet nga punonjës të shquar të shkencës dhe të artit në vend, ka anëtarë të rregullt, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi. Ka tri organe drejtuese kryesore: kuvendin, kryesinë dhe kryetarin. Kuvendi është organi më i lartë, i përbërë nga të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të saj. Kuvendi është organ vendimmarrës, i cili miraton statutin, rregulloret e ndryshme dhe akte e tjera normative, planin dhe programin e punës, planin financiar, zgjedh anëtarët e rregullt, anëtarët korrespondentë, anëtarët e jashtëm dhe të nderit, zgjedh kryesinë, krijon seksione, bërthama të studimit, njësi shkencore dhe qendra studimore. Kryesia e Akademisë përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari i përgjithshëm, sekretarët e seksioneve dhe zbaton vendimet e kuvendit të Akademisë. Sipas Statutit të ASHAK-ut (2005, plotësuar më 2016), detyrat e Akademisë janë: realizimi i projekteve shkencore dhe artistike, botimi i rezultateve të kërkimeve shkencore, botimi i veprave të shkencës dhe të arteve me rëndësi të veçantë për zhvillimin e shkencës dhe të arteve në Kosovë, nxjerrja e botimeve të veta dhe e raporteve të punës, organizimi i tubimeve shkencore, simpoziumeve, konferencave shkencore, sesioneve shkencore, tryezave shkencore, të ekspozitave, koncerteve, konsultave e të tjera; pjesëmarrja në përcaktimin e synimeve

të zhvillimit të shkencës dhe të arteve në Kosovë; shprehja e mendimeve dhe e propozimeve mbi zhvillimin e shkencës e të artit etj. Kjo realizohet nëpërmjet katër seksioneve: Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Seksioni i Shkencave të Natyrës dhe Seksioni i Arteve. Seksionet udhëhiqen nga sekretarët e seksioneve. Veprimtaria shkencore dhe artistike e ASHAK-ut pasqyrohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe artistike vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet botimeve të veçanta, kryesisht të anëtarëve të saj, si dhe në periodikun akademik, si: “Vjetari”, “Kërkime” dhe “Studime”. ASHAK-u është anëtare në disa organizma ndërkombëtarë, siç janë: Federata e Akademive Kombëtare të Europës (ALLEA), bashkëthemeluese e Unionit të Akademive të Europës Juglindore, anëtare e Rrjetit Ndërkademi për të Drejtat e Njeriut (Nju-Jork), e Asociacionit të Studimeve të Europës Juglindore etj. Ajo bashkëpunon me institucione simotra në vende të tjera. Ka marrëveshje të veçantë bashkëpunimi, me projekte konkrete, me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, pastaj me Akademinë e Kroacisë, me Akademinë e Sllovenisë, me Akademinë Mbretërore Belge Flamane, me Akademinë Kombëtare Italiane, me Akademinë Britanike, me Akademinë e Shkencave të Getingenit etj. (Hajrullah Koliqi)

AKADEMITË PEDAGOGJIKE. Shkollë e lartë për arsimimin profesional të mësuesve të shkollës fillore dhe të edukatorëve të institucioneve të edukimit parashkollor. U hapën si rezultat i nevojës për ngritjen profesionale të kuadrit arsimor në këto institucione. Në Kosovë u hapën me vendimin e Sekretariatit për Arsim, Shkencë e Kulturë të KSA të Kosovës të vitit 1973. Filluan të punojnë në vitin shkollor 1974/75, kur katër shkollat normale (e Prishtinës, e Gjakovës, e Prizrenit dhe e Gjilanit) shndërrohen në akademi pedagogjike. Ishin shkolla me studim gjashtëvjeçar, sipas modelit 4+2. Plani i studimeve gjatë dy viteve të fundit në akademinë pedagogjike përfshinte lëndë profesionale: pedagogji, didaktikë, metodikë të lëndëve të veçanta, psikologji pedagogjike etj. Veprimtaria e tyre u ndërpre me vendimin e Sekretariatit për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të KSA të Kosovës (1978). Akademitë pedagogjike u integruan me shkollat e larta pedagogjike,

ku arsimimi i lartë i mësuesve vijoi si drejtim i veçantë - grupi i mësimit klasor. Arsimimi universitar i mësuesve të shkollës fillore dhe të edukatorëve të institucioneve të edukimit parashkollor në Kosovë filloi me themelimin e Fakultetit të Mësuesisë në Prishtinë (1997). (Islam Krasniqi)

AKCIZA. Taksë që u ngarkohet produkteve të caktuara në qarkullim. Konsiderohet si taksë indirekte, meqë prodhuesi apo shitësi që e paguan atë, fillimisht pritet ta shpërndajë si tërësi të blerësit e tjerë nëpërmjet rritjes së çmimit për ta. Akcizat dallojnë nga taksat e tjera në dy aspekte: së pari, akciza aplikohet për një grup të ngushtë të produkteve të parapërcaktuara nga autoritetet përkatëse; dhe, së dyti, akciza vendoset jo domosdo vetëm si vlerë e shtuar, por edhe në varësi nga rastet, si vlerë për njësi. Përveç qëllimeve financiare, pra të mbledhjes së të hyrave, akciza shërben edhe për qëllime të politikave rregulluese, në radhë të parë për sigurinë publike, përkujdesjen shëndetësore, mbrojtjen e ambientit apo zvogëlimin e konsumit të produkteve jopërfituese. Në Kosovë akciza kontrollohet dhe menaxhohet nga Doganat e Kosovës. Të gjitha taksat e akcizës të arkëtuara nga dogana depozitohen në buxhetin e Kosovës. Produktet më të zakonshme që kanë akcizë në Kosovë janë: duhani, kafja, alkooli, derivatet e naftës etj. Në Kosovë akciza për produktet e importuara sillet në vlerë të shtuar nga 0% deri në 10%. Në produktet e tjera, sikurse nafta, ajo ka vlerë fikse. (Lumir Abdixhiku)

AKLLAPI Rexhep (1900-1972). Pjesëtar i lëvizjes kaçake dhe veprimtar antikomunist. Lindi në fshatin Akllap të Lipjanit. Si i ri iu bashkëngjiti çetës së Ilaz Reçakut dhe Ibush Vuçitërnaliut nga Prishtina. Kur më 1921 shpallet amnistia e përgjithshme për kaçakët, për të shpëtuar nënën që e kishte të internuar në burgun e Nishit, ai dorëzohet. Mirëpo e ëma i vdes në burg. Emërohet xhandar dhe dërgohet në Mitrovicë (1924). Kur e heton se synojnë ta dërgojnë në Galicë për të luftuar kundër komandantit të tij, Azem Bejtës, dezerton dhe bashkë me familjen, për të humbur gjurmët, largohet në Prilep të Maqedonisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore rreshtohet në anën forcave nacionaliste dhe angazhohet kundër bashkëpunimit me komunistët dhe partizanët

serbo-malazez. Pas përfundimit të luftës nuk u pajtua me pushtetin e ri dhe e luftoi atë. Në verë të vitit 1945, bashkë me shumë bashkëluftëtarë, u detyrua të tërhiqet nëpër Maqedoni-Greqi, për t'u vendosur më pas në Turqi. Vdiq në mërgim. (Liman Rushiti)

AKSIONARËT. Pronarë të kapitalit të investuar në një kompani. Aksionarë mund të jenë personat fizikë apo juridikë, të cilët e fitojnë të drejtën e pronësisë përmes posedimit të aksioneve. Aksionet mund të jenë aksione të "zakonshme" dhe "preferenciale". Aksionet e zakonshme i sigurojnë pronarit legjitimit të drejtën e votës përderisa ato preferenciale bartin disa privilegje, si përparësia në shpërndarjen e dividendës, shitjes, kompensimit në rast të falimentimit të kompanisë, por nuk sigurojnë të drejtën e votës. Aksionarët ushtrojnë ndikimin e tyre përmes kuvendit të aksionarëve, i cili organizohet për çdo vit përderisa kompania është funksionale. Në kuvendin e aksionarëve bëhet zgjedhja ose shkarkimi i anëtarëve të bordit drejtues (shpesh i referuar si bord i drejtorëve) dhe nganjëherë edhe i kryeshefit ekzekutiv të kompanisë. Nevoja për përqendrimin e kapitalit e ka stimuluar edhe paraqitjen e konceptit të aksionarit. Në ekonomitë e zhvilluara, ku funksionojnë bursa të këmbimit të aksioneve, kompanitë ofrojnë aksionet e tyre për tregtim të lirë. Ndonëse ligji për shoqëritë tregtare e ka rregulluar këtë formë të organizimit të biznesit, në mungesë të tregut të letrave me vlerë, emetimi i aksioneve në Kosovë ende nuk është aq i pranishëm. (Gëzim Tosuni)

AKSIONI I CARRALEVËS (1943). Sulmi i parë dhe më i reëndësishëm i Aradhes partizane "Zenel Hajdini", që u krye më 2 janar 1943 në grykë e Carralevës, nën komandën e Fadil Hoxhës. Sulmi u organizua kundër autokolonës italiane të automobilave afër fshatit Carralevë, në rrugën Prizren-Ferizaj. Aradhja e ndarë në tri grupe i zuri pritën autokolonës së karabinierisë italiane, e cila vinte nga Prishtina në drejtim të Prizrenit. Në këtë luftim u vranë 21 ushtarë italianë dhe kapiteni i tyre, Lipari Karmelo. Aradhja pati vetëm një të vrarë, Abdullah Shabanin nga Mitrovica. Pas aksionit, aradhja partizane u detyrua të tërhiqej, sepse arritën forca të mëdha italiane. Aksioni pati jehonë në tërë Kosovën. (Fehmi Rexhepi)

AKSIONI I LLOJANIT (1942). Aksion i Aradhes partizane “Zenel Hajdini”, bashkë me aradhën e Vranjës, i ndërmarrë më 19 tetor 1942 në minierën e kromit dhe antimonit në Llojan të Kumanovës. Miniera eksploatohej nga gjermanët dhe bullgarët, ndërsa xehet dërgoheshin në Gjermani për nevoja të industrisë ushtarake. Një grup partizanësh hyri natën në minierë, ndërsa grupi tjetër u mor me neutralizimin e rojave. Drejtori dhe mbarë udhëheqja e minierës u zonë robër. Miniera u paralizua. U zhdukën planet e minierës dhe të instalimit elektrik, u konfiskuan të hollat, ushqimi dhe eksplozivi. Pas përfundimit të aksionit, Fadil Hoxha mbajti një fjalim para punëtorëve dhe fshatarëve të tubuar, ku shpjegoi qëllimin e aksionit në minierë. Përveç efektit propagandistik, aksioni i Llojanit pati rëndësi edhe për faktin se u shkatërrua një objekt ekonomik i rëndësishëm për nevojat e ushtrisë nazifashiste. (Fehmi Rexhepi)

AKSIONI I MBLEDHJËS SË ARMËVE NË KOSOVË (1955-1956). Proces politiko-ushtarak, i cili gjatë një periudhe katërmujore (dhjetor 1955-mars 1956) mori përmasat e një terrori të organizuar shtetëror. Aksioni u drejtua kryesisht kundër shqiptarëve. Filloi në Vrellë të Istogut, për të vazhduar pastaj në tërë Kosovën. Në këtë aksion u angazhuan mekanizmat ushtarako-policorë, ato partiake dhe të sigurisë. Aksioni u zbatua me metoda të egra, represive e terrorizuese deri në vrasje. Ai që nuk kishte pushkë, detyrohej ta blinte ose përfundonte në burg. Gjatë aksionit u rrahën dhe u keqtrajtuar rreth 30,000 shqiptarë dhe nga torturat vdiqën 105 veta. Njëkohësisht burgjet u mbushën me shqiptarë, veçmas me ata që nuk kishin armë për t'i dorëzuar. UDB-ja në Kosovë hapi 22,038 dosje kundër shqiptarëve, nga të cilat 240 ishin për personalitete me ndikim, përfshirë edhe intelektualë. Vetëm në Burgun e Nishit vuajtën dënimet 2,000 veta, në atë Mitrovicës së Sremit 700 shqiptarë dhe shumë të tjerë në Burgun e Idrizovës në Maqedoni, të Goli Otokut etj. Sipas statistikave zyrtare të Jugosllavisë, në Kosovë në vitin 1954 u gjykuan 2,981 shqiptarë, ndërkaq në vitin 1956 arriti në 3,213 veta. Aksioni ndikoi në përshpejtimin e shpërnguljes së shqiptarëve dhe keqësimin e gjendjes ekonomike të popullsisë. Aksioni u shtri në tërë Kosovën dhe në viset e tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë. (Sulltane Ukaj)

AKSIONI PËR HEQJEN E FEREXHESË. Ishte një ndër aksionet e para të pushtetit komunist për emancipimin e femrës në Kosovë. Bartësit kryesorë të aksionit ishin Fronti Popullor, Komiteti i Shqiptarëve, mësuesit, rinia, forcat progresive, klerikët përparimtarë, veçmas inteligjencia shqiptare. Deri në vitin 1947 aksioni u kuptua si çështje e përkohshme, e jo si një çështje e luftës më afatgjate. Kishte raste kur ferexheja rikthehej. Në disa raste vetë aktivistët u bënë pengesë për zbatimin e aksionit. Edhe kleri shpeshherë paraqiste pengesë për realizimin e aksionit. Në Konferencën e Parë të Ylemave në vitin 1947, ku morën pjesë 221 delegatë myslimanë, anëtarë të Komitetit të Shqiptarëve dhe të Frontit Antifashiste të Gruas, u diskutua që të ndihmohej ky aksion. Gjatë vitit 1947 ferexhenë e hoqën 25,000 femra shqiptare. Aksioni vazhdoi edhe në vitet në vijim. Kjo çështje u konsiderua si njëra ndër detyrat kryesore të Frontit Popullor, të Komitetit Nacional të Shqiptarëve dhe forcave të tjera politiko-shoqërore. Për këtë u shfrytëzuan forma të ndryshme pune, takime me grupe qytetarësh, ligjërata të ndryshme, shfaqje, manifestime kulturore etj. Para se të hynte në fuqi Ligji për ndalimin e ferexhesë në Kosovë, ferexhenë e hoqën 79,661 femra. Më 25 mars të vitit 1951 u miratua ligji mbi ndalimin e mbajtjes së ferexhesë. Me ligj parashihej jo vetëm ndalimi i ferexhesë, por edhe çdo formë e mbulimit të fytyrës. (Sulltane Ukaj)

AKTET DHE DIPLOMAT QË ILUSTROJNË SHQIPËRINË MESJETARE (*Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*). Një ndër publikimet më të rëndësishme të dokumenteve burimore historike që i kushtohen Shqipërisë mesjetare. Hulumtimi dhe përzgjedhja e dokumenteve historike është realizuar nga mediavalistët Taloçi (Ludovicus de Thallóczy), Jireček (Constantinus Jireček) dhe Shuflaj [Emilianus (Milan) de Sufflay]. Përmbledhja është botuar në dy vëllime, i redaktuar nga Milan Shuflaji. Vëllimi i parë u botua në Vjenë, në vitin 1913, dhe përfshin dokumente të proveniencës burimore latine, bizantine dhe sllave, që i referohen viteve 1344 deri më 1343. Vëllimi i dytë po ashtu është botuar në Vjenë, në vitin 1918, me përmbledhje të burimeve nga arkivat kryesisht italiane dhe dalmatine, që përfshijnë periudhën e viteve 1344-1406. Dokumentet

ofrojnë lëndë të rëndësishme për njohjen e Shqipërisë mesjetare. Dokumentet nuk i referohen tërë hapësirës etnike shqiptare, por kryesisht katërkëndëshit hipotetik të shtrirjes së etnosit shqiptar gjatë mesjetës. Duke parë rëndësinë e këtyre materialeve, autorët kanë synuar të publikojnë edhe katër vëllime, që do të përfshinin harkun kohor deri në gjysmën e shek. XVI. Ndërkohë, derisa Taloçi dhe Jireçek-u kishin vdekur, Shuflaj deklaronte se po përgatiste vëllimin e tretë të dokumenteve, që do të përfshinte vitet 1406-1536, por vdekja e tij tragjike më 1931 bëri që dokumentacioni i përgatitur të humbet. Së fundi, në Arkivin Qendror të Shqipërisë është gjetur një dosje nga viti 1931 me rreth 50 faqe material. Dosja është një pasqyrë lënde me tituj për historinë e Shqipërisë në vitet 1400-1536, që u përket materialeve të përgatitura për vëllimin e tretë të "Akteve dhe diplomave" nga Shuflaj. Një pjesë e kësaj lënde ndodhet në Arkivin e Shtetit të Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër në arkivat e Venedikut, Vatikanit, Napolit, Dubrovnikut, Vjenës etj. (Muhamet Mala)

AKTET E ARBËRISË VENETE (*Acta Albaniae Veneta*). Përmbledhje dokumentesh nga arkivat venedikase, të cilat ndriçojnë historinë e Arbërisë në shek. XIV-XV (*Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, Josephi Valentini S. J., Palermo-Napoli-Roma-Venezia-Munhen 1967-1979). Botimi u bë nga Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Shqiptare me seli në Palermo, në bashkërendim me institutet analoge në Romë, Venedik dhe Napoli, si dhe me tri institute të Munihut, me rastin e 500 -vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeut. Aktet ose diplomat janë të botuara dhe të sistemuara sipas standardeve moderne, që dalin nga shkencat themelore ndihmëse të historisë, diplomacisë dhe paleografisë. Si të tilla, ato nuk janë vetëm regesta, por akte të transkriptuara nga dokumentet origjinale të shkruara kryesisht në gjuhën latine mesjetare. Edicioni, ku janë përfshirë 7,667 akte ose diploma, shoqërohet me hyrje, shënime të sakta të fondeve ku ruhen ato, komente thelbësore, indekse me lista kronologjike të dokumenteve të publikuara, indeks të veçantë për emra personalë, gjeografikë dhe lëndorë, një fjalor dhe glosa të vjetra, që i bashkëngjiten çdo pjesë të edicionit. Ato janë redaktuar

kryesisht në latinishten mesjetare, të pasur me elemente të gjuhës lokale venete dhe shqipe, ose pjesërisht në gjuhë bizantine dhe katalane. Edicioni përfshin vertikale të gjatë historike, duke u nisur nga 17 qershori 1301 deri në fund të vitit 1463. (Jahja Drançolli)

AKTET KUSHTETUESE TË KSA TË KOSOVËS (1946-1974). Janë kushtetutat dhe aktet e tjera ligjore, të cilat përcaktuan pozitën kushtetuese të Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe pozita e Kosovës evoluoi në katër faza. Faza e parë (1946-1953) karakterizohej me nxjerrjen e tri akteve kryesore: të Kushtetutës së Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë (RPFJ, 31 janar 1946), të Kushtetutës së Republikës Popullore të Serbisë (RPS, janar 1947) dhe të Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë (KAKM, 23 maj 1948).

Kushtetuta e RFPJ-së e vitit 1946 e përcaktonte Kosovën si krahinë autonome dhe si element konstitutiv të federalizmit, e cila njëkohësisht përfshihej në kuadrin e strukturës kushtetuese të Serbisë. Ajo përcaktonte pozitën kushtetuese të krahinave autonome dhe njëkohësisht parashihte garancitë federative për realizimin e të drejtave të tyre të përcaktuara me kushtetutë. Gjatë kësaj faze të zhvillimit kushtetues, Kosova ka pasur subjektivitet politik, i cili është shprehur me përfaqësimin e saj në organet e larta federative. Statuti i Kosovës i vitit 1948 ka qenë akti i parë i përgjithshëm normativ i Kosovës, i cili shprehte një formë të pavarësisë së saj në sferën organizative. Me Statut janë përpunuar çështje më të rëndësishme nga sfera e të drejtave dhe e detyrave të Krahinës, organizimi i saj, fushëveprimi i organeve krahinore, organizimi i pushtetit lokal etj.

Në fazën e dytë (1953-1963) u bë rishqyrtimi i pozitës kushtetuese të Kosovës me Ligjin Kushtetues të RFPJ-së (1953), Ligjit kushtetues të RP të Serbisë (1953) dhe Statutit të dytë të Kosovës (1953). Për dallim nga periudha e mëparshme, kur pozita kushtetuese e Kosovës përcaktohej me Kushtetutën Federative, tani të drejtat dhe detyrat e Kosovës ekskluzivisht përcaktoheshin me Ligjin Kushtetues të RP të Serbisë. Kjo pati për pasojë zbehjen e dukshme të mëvetësisë dhe trajtimin e të drejtave dhe detyrave të Kosovës jo si të drejta burimore, por si autorizime, të cilat Republika i barte në organet e Kosovës. Në këto rrethana, Kosova humbi

pozitën e subjektit federativ (të përcaktuar me Kushtetutën e RFPJ-së të vitit 1946) dhe ishte shndërruar në kategori republikane. Për dallim nga periudha e mëparshme, Ligji Kushtetues i RP të Serbisë paraqiste aktin themelor për krijimin e funksioneve dhe për përcaktimin e pozitës kushtetuese-juridike të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, në vitin 1953, Kosova nxjerr Statutin e saj të dytë, me të cilin ajo merrte këto autorizime: të rregullonte çështjet me interes për Krahinën nga lëmi i ekonomisë, i arsimit, i kulturës, i shëndetit popullor dhe i kujdesit social; përkujdesej për zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera të organeve federative dhe të republikave në territorin e Krahinës dhe kujdesej për ruajtjen e rendit publik etj.

Faza e tretë (1963-68/71) veçohet me miratimin e Kushtetutës së RSFJ-së (1963) dhe të kushtetutave të republikave socialiste. Në vitin 1963 Kosova kishte nxjerrë Statutin e saj të tretë dhe të fundit. Ky Statut nuk solli ndonjë risi sa i përket pozitës kushtetuese juridike të saj. Pozita e tillë ka reflektuar në organizimin dhe funksionimin e tërësishëm, që për pasojë kishte zbehjen e dukshme të mëvetësisë së Kosovës dhe vënien e pozitës së saj në suaza të autonomisë së thjeshtë administrative-territoriale. Por, ndryshimi i bazës kushtetuese-ligjore në vitet e fundit të kësaj faze, me amendamentet kushtetuese të viteve 1968, 1971 dhe 1972 (në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1963) dhe të Ligjit Kushtetues të KSA të Kosovës të vitit 1969 bënë një kthesë të rëndësishme në përmirësimin e pozitës së popullit shqiptar në përgjithësi dhe të statusit politik dhe kushtetues të Kosovës. Ndryshimi kryesor qëndronte në rikthimin e atributit “konstitutiv”, sipas të cilit Kosova (sikurse edhe Vojvodina) përsëri përcaktohet si pjesë konstitutive e strukturës federative të ish-Jugosllavisë. Pas miratimit të Ligjit Kushtetues si akti më i lartë juridik më 24.2.1969, Kosova gëzonte autorizime relativisht të gjera legjislative. Autorizimet e mëparshme normative të karakterit nënligjor ishin zëvendësuar me autorizime të gjera legjislative. Ligji Kushtetues i KSA të Kosovës paraqiste aktin themelor politiko-juridik të Krahinës.

Faza e katërt (1971-1974) është e lidhur me nxjerrjen Kushtetutës së ish-RSFJ-së (1974) me të cilën u avancua edhe pozita kushtetuese-juridike e Kosovës në kuadrin e federalizmit jugosllav. Kosova kishte fituar statusin e njësisë

së mëvetësishme politike dhe autonome, si element konstitutiv i Federatës Jugosllave. Kjo kushtetutë parashihte të drejtën e vetëpërcaktimit të ri statusor-konstitucional të Kosovës pas shpërbërjes së RSFJ-së. Zgjidhjet e tilla kushtetuese i mundësuan Kosovës rregullimin autonom të pozitës së saj me anë të Kushtetutës si akti themelor dhe më i lartë, duke përcaktuar bazat e sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror, organizimin e vet të brendshëm, si dhe raportet e saj me Federatën dhe me RS të Serbisë. (Arsim Bajrami)

ALA VESPAZIANA DARDANORUM. Regjiment kalorësish dardanë. U formua në Mezi të Poshtme gjatë sundimit të perandorit romak Vespazian (69-79). Përbëhej nga 1,000 kalorës dardanë, të cilët ndaheshin në 24 “turmae”, nën komandën e udhëheqësit romak, i besueshëm nga perandori. Komandant i hershëm ishte Mullius Ofillius Restitus, emri dhe posti i të cilit është shënuar në stelën nga qyteti antik Gremetum (Lukani, Itali). A. Evans përmend tri diploma ushtarake kushtuar tre veteranëve të regjimentit dardan dhe i referohet dhe monumentit nga Mirkovci (Maqedoni) kushtuar veteranit Julius Longinus. Në mbishkrimin nga Tangjeri (Marok) gjendet emri i Publius Besius me titull prefekti, i cili kishte marrë pjesë në fushatën e dytë ushtarake të Dakisë (105-106) dhe ishte shpërblyer me shtizën e dytë, kurorën e dytë dhe medaljen e argjendit nga perandori Trajan (98-117). Prezenca e regjimentit dëshmohet edhe në qytetet Arribum (Macin) dhe Barbosh të Rumanisë, ndërsa lëvizjet e tij në provincat Mezi e Epërme dhe Daki janë dëshmuar deri në periudhën e perandorit Anton Piu (138-161). (Arianit Buçinca)

ALAJ Ali (1949-). Gazetar. Lindi në Drenoc të Deçanit. Shkollën fillore e nisi në vendlindje dhe e vazhdoi në Pejë, ku kreu edhe gjimnazin. Fakultetin e Drejtësisë e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Në gazetën “Rilindja” punoi nga viti 1971 deri më 1974, pastaj u emërua redaktor i programit informativ në Televizionin e Prishtinës, deri në mbylljen e tij nga Serbia më 1990. Gjatë viteve ’90 punoi në gazetën “Dielli”, që botohej në Zagreb dhe bashkëpunoi me gazetatat “Bujku”, “Ora”, “Alternativa” etj., që botoheshin në Prishtinë e Lubjanë, si dhe me gazetatat kroate “Vjesnik” e “Danas”. Ka

raportuar për ngjarjet e rëndësishme politike në Kosovë dhe ish-Jugosllavi, si dhe ka shkruar një sërë komentesh politike. Jeton në SHBA. (Zenun Çelaj)

ALAJ Musa (1946-). Gazetar i sportit. Lindi në Drenoc të Deçanit. Si nxënës i Normales së Prishtinës iu përkushtua lojës së hendbollit. Luajti për KH “Deçani”, pastaj edhe për KH “Prishtina”. Pas lojës aktive, u bë gjyqtar i hendbollit në të gjitha ligat e atëhershme, përfshirë edhe ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë pesë vjet rresht. Deri në vitet ‘90 bënte pjesë në udhëheqjen e Lidhjes së Hendbollit të Kosovës. Më 1991 ishte njëri prej kontribuesve për pavarësimin e sportit të Kosovës, duke i themeluar shumicën e federatave të sportit të Kosovës dhe ligat e rregullta të Republikës. Me gazetari filloi të merret që kur ishte student. Më 1971 nisi punën si gazetar fillestar në redaksinë e revistës “Zëri”, ku punoi deri në vitin 1985, më pas kaloi në të përditshmen “Rilindja” (“Bujku”), në rubrikën e sportit. Më 1995 emigroi në Belgjikë, ku jeton edhe aktualisht. Gjatë viteve të punës në “Zëri” dhe “Rilindje” raportoi nga shumë ngjarje sportive, si olimpiada, kampionate botërore e europiane etj. (Gani Kosumi)

ALAJ Riza (1936-2008). Drejtues i medieve elektronike dhe punëtor arsimit. Lindi në Drenoc të Deçanit. Filloren e kreu në Deçan, Shkollën Normale në Prishtinë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. Punoi mësues në Silbicë të Prizrenit, në Stantërg të Mitrovicës dhe në Deçan. Si mësimdhënës i gjuhës shqipe punoi në Normalen e Prizrenit (1965-1971). Ndërkohë ushtroi funksione me përgjegjësi politike dhe menaxhuese në arsimin e Kosovës. Më 1974 emërohet drejtor i TV Prishtinës, ndërsa dy vjet më vonë drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Prishtinës. Më 1982 u zgjodh deputet federativ nga Kosova dhe njëherësh shef i grupit të deputetëve nga Kosova në Kuvendin Federativ. (Zenun Çelaj)

ALBANISTIKA. Kompleks fushash të studimit të gjuhës shqipe. Në Kosovë termi është përdorur për herë të parë nga Selman Riza (1952). Ndryshon nga termi Albanologji, sepse kufizohet vetëm në çështjet e gjuhës dhe nuk shtrihet në ato të letërsisë, të historisë dhe të

kulturës. Shënimet e para gjenden te “Fjalori” i Frang Bardhit (1635), ndërsa studimet e para të mirëfillta për gjuhën shqipe dokumentohen në fillim të shekullit XVIII, kur kemi gramatikat e para të shqipes: dorëshkrimi i Grotaferratës (1710) dhe gramatika e Da Leçes (1716). Vetë Da Leçe ka hartuar edhe një fjalor, i cili besohet i zhdukur. Në shekullin XVIII studimet për shqipen janë ndjekur nga Tunmani (1774), i cili mbështeste teorinë ilire të prejardhjes së shqiptarëve në librin e tij mbi historinë e popujve të Europës Lindore. Në atë kohë me çështjen e prejardhjes së shqipes merrej edhe filozofi Lajbnic (Leibnitz). Në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX albanistika ka qenë më shumë e orientuar nga historia e shqipes, duke qenë objekt studimi nga autorë si Franc Bop, Dhimitër Kamarda, Franc Mikloshiq, Gustav Majer, Georg fon Han, Norbert Jokl, Holger Pedersen, e më pas Rajko Nahtigal, Stuart Man, Erik Hemp, Agia Desnickaja, Herman Ëlberg, Haralambie Mihëjesku, Eqrem Çabej, Selman Riza e të tjerë. Majeri botoi fjalorin etimologjik të shqipes. Më 1854, Franc Bopi, si një ndër themeluesit e albanistikës shkencore, argumentonte se shqipja përfaqëson një degë më vete në drurin gjenealogjik të gjuhëve indoeuropiane. Gjatë Rilindjes Kombëtare ka pasur interesim të shtuar të vetë shqiptarëve për shqipen. Naum Veqilharxhi më 1845 botoi “Evetarin”, ndërsa më 1879 u themelua “Shoqata e të shtypurit shkronja shqip”. Në atë kohë u botuan gramatikat e para normative të Kristoforidhit dhe të Sami Frashërit, si dhe gramatikat e Zef De Radës e Dhimitër Kamardës, në mesin e arbëreshëve të Italisë. U botua “Fjalori i gjuhës shqipe” i Konstantin Kristoforidhit (më 1904, pas vdekjes së autorit) dhe më 1909 Fjalori i Shoqërisë “Bashkimi”. Në atë kohë u punua për njësimin e alfabetit të shqipes, të zgjidhur më 1908 në Kongresin e Manastirit. “Komisia Letrare e Shkodrës”, ndërkaq, më 1916 punoi për njësimin e shqipes letrare, duke zgjedhur të folmet e Shqipërisë së Mesme si bazë për shqipen letrare. Vendimet e kësaj Komisie janë miratuar më 1920 në Kongresin Arsimor të Lushnjës dhe janë zbatuar deri në Luftën e Dytë Botërore. Pas Luftës, politikat gjuhësore janë realizuar me projekte dhe konferenca në Kosovë e në Shqipëri, kanë kulmuar me Kongresin e Drejtshkrimit të mbajtur më 1972

në Tiranë, ku është caktuar gjuha e njësuar letrare shqipe me bazë toskërishten.

Nëshekullin XX, studimet më shumë orientohen nga strukturat e shqipes. Gaj Loman në vitet '30 botoi në SHBA një studim për sistemin tingullor të shqipes. Pas Luftës së Dytë Botërore ka studime më intensive dhe më sistematike të shqipes në Shqipëri dhe në Kosovë. Në këtë kuadër u botuan disa gramatika, kryesisht për nevoja didaktike, fjalorë dygjuhësh e studime të veçanta. Në këtë kohë u shquan Aleksandër Xhuvani, pastaj Eqrem Çabej, Selman Riza, në Kosovë Idriz Ajeti. Në vitet '70 shqipja arriti të ketë drejtshkrimin e saj, të ketë gramatikën normative, fjalorin, pastaj atlasin dialektologjik, mbështetur në studime të shqipes. U studiuan tekstet e vjetra të shqipes. Në botë u botuan gramatika nga Leonard Njumark, Martin Camaj, Oda Buholc e Vilfrid Fidler. Ka studime të strukturës së shqipes në sinkroni dhe në diakroni. Autorë si Hemp, Desnickaja e të tjerë trajtojnë probleme të ndryshme të shqipes. Buholc në fund të viteve gjashtëdhjetë trajtoi problemin e rimarrjes së kundrinës në këndvështrim gjenerativ, ndërsa Bevington në këndvështrim gjenerativ trajtoi fonologjinë e shqipes. Albanistika lidhet edhe me hapjen e departamenteve për mësimin e shqipes. Si departament më i vjetër konsiderohet ai i Napolit, ideuar nga De Rada, por ku fillimisht ka mbajtur mësim Serembe. Departament i vjetër është ai i Beogradit (1921), ndërsa në Shën Peterburg të Ruisë është hapur më 1957. Shqipja sot mësohet edhe në qendrat si në Paris, Muni, Kozencë, Romë, Venecia, Budapest, Pragë, Varshavë, Torunj, Sofie, Edrene, Ohajo, Indiana, Arizona etj.

Në Kosovë (përgjithësisht në viset shqiptare në ish-Jugosllavi) studimet albanistike institucionalisht kanë nisur me themelimin e Institutit Albnologjik më 1953, për të vijuar me Shkollën e Naltë Pedagogjike më 1958 dhe sidomos me themelimin e degës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik më 1960, për të vijuar me Institutin Albanologjik më 1967 dhe me rrjetin e institucioneve të zhvilluara në vijim. Këto studime kanë qenë komplekse, duke filluar nga struktura gramatikore e fonetike e gjuhës së sotme, e deri të çështjet e dialektologjisë, të historisë së gjuhës, të teksteve të vjetra, të kontakteve me gjuhët fqinje etj. Për çështje të historisë së gjuhës, të dialektologjisë historike, të kontakteve me gjuhët sllave dhe

të proceseve të standardizimit është shquar Idriz Ajeti, ndërsa në fusha të studimeve morfosintaksore, tekstologjike dhe dialektologjike autorë si Hilmi Agani, Latif Mulaku, Murat Blaku, Tafil Kelmendi etj. Në vitet '70 nisin trajtimet strukturale të shqipes me autorë Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Olivera Jashar-Nasteva. Shqyrtime sociolinguistike janë vetëm të dy dekadave të fundit. Ka pasur dhe ka edhe një varg revistash e konferencash shkencore për çështje të caktuara të albanistikës, ndërsa Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, i themeluar më 1974 në Prishtinë, ka qenë një dritare e hapur për studimet e shqipes ndër të huaj. Në dekadat e fundit ka studime të shumta për sfera të ndryshme të shqipes si nga autorë shqiptarë, ashtu edhe nga të huaj në këndvështrime të ndryshme dhe në fusha të ndryshme të gjuhësisë. (Bardh Rugova)

ALBANIZMAT. Në kuptimin e përgjithshëm: veçori karakteristike të kulturës shqiptare; në kuptim më të ngushtë: veçori karakteristike të gjuhës shqipe që janë huazuar në gjuhë të tjera. Si veçori të kulturës mund të kundrohen veçoritë kulturore-materiale: plisi (qeleshja), fustanella etj. Si veçori kulturore jomateriale mund të konsiderohen besa, shtojzovallet, llojet e valleve, por edhe elemente gjuhësore e të tjera. Për albanizmat e tillë kanë shkruar, mes tjerësh, Gani Bobi e Sabri Hamiti. Si elemente gjuhësore të huazuara në gjuhë të tjera mund të konsiderohet, ta zëmë, *sicca* (një lloj kame, thikë) në latinishten. Ndryshimi i statusit të shqipes në Kosovë bën që të ketë edhe kahe të tjera të huazimeve në raport të shqipes së Kosovës me gjuhët e tjera në kontakt. Albanizma mund të konsiderohen strukturat analitike në të folmet turke të Kosovës. Po ashtu mund të përmendim disa fjalë si *gëlbazë* (nga *kalb*), *gard* (nga *gardh*), *brad* (nga *bredh*) në rumanishten. Rumunishtja nuk ka shumë fjalë nga shqipja, por ato i përkasin një shtrese të vjetër. Për ndikimin e shqipes në të folmet e serbëve në Kosovë kanë shkruar Idriz Ajeti, Murat Blaku etj. Për huazimet e shqipes në gjuhë të tjera sllave kanë shkruar Ivan Popoviq, Qemal Murati etj. I. Popoviqi i sheh si albanizma fjalën *fara* nga shqipja në gjuhë si greqishtja e re, rumanishtja e bullgarishtja, fjalën *zvrčka* në gjuhët sllave të jugut nga shqipja *zverk*. Për albanizmat nuk ka studime

të shumta. Më herët Sandfeldi përmend disa albanizma në gjuhët sllave, në mesin e të cilave edhe disa të gabueshme. Majeri ka trajtuar disa albanizma në greqishten e re, pastaj ka pasur disa studime të rastit të Kreçmerit, të Joklit, të Fasmerit e të ndonjë tjetri. (Bardh Rugova)

ALBANOLOGJIA. Fushë komplekse disipli-nash studimi të gjuhës, të letërsisë, të historisë, të etnologjisë dhe të kulturës shqiptare përgjithësisht. Ka nisur si disiplinë studimi në shekullin XVIII, për t'u konsoliduar në pjesën e dytë të shekullit XIX. Si objekte themelore studimi në atë periudhë kanë qenë fillimisht historia e gjuhës, lidhja e saj me gjuhët e tjera e pastaj historia-zhvillimi i popullit, etnokultura dhe çështje të tjera të jetës së shqiptarëve. Megjithatë, përpjekjet e para kanë qenë më shumë të fushës së gjuhës, pra albanistike, por edhe të historisë me autorë si Tunman, Han, Majer e ndonjë tjetër. Hahni më 1853-54 botoi "Studime shqiptare" duke trajtuar probleme të gjuhës, por edhe të historisë, të folklorit, të etnografisë dhe të gjeografisë, duke qenë një themel i qëndrueshëm për studime të mëvonshme albanologjike në botë. Në rrafshin e studimeve të historisë së popullit shqiptar ka pasur përpjekje për mbledhjen e materialeve dhe të burimeve historike që trajtojnë marrëdhëniet e popullit shqiptar me popujt e tjerë. Në fushën e arkeologjisë dhe të etnografisë ka pasur përpjekje që në filltet e shekullit XX. Hulumtimet arkeologjike kishin në thelbin e tyre më shumë kulturën antike, duke synuar gjetjen e përgjigjeve rreth kulturës ilire dhe parailire, si dhe të lidhjes së ilirëve me arbrit. Studimet e etnologjisë, po ashtu, kanë një shtrirje të gjerë, duke synuar trajtimin e gjendjes materiale të shqiptarëve ndër shekuj dhe në raport me popujt e tjerë. Një pjesë e këtyre studimeve në zanafillë kanë trajtime ekzotike për shqiptarët. Studimet më të pasura në fushën e albanologjisë janë ato albanistike, pra studimet e gjuhës shqipe. Një ndër themeluesit e kësaj fushë është Bopi, i cili në studimet e veta e shihte shqipen si degë më vete të gjuhëve indoeuropiane.

Në trojet shqiptare ekzistojnë institucione të veçanta, që merren me studime albanologjike. Në Shqipëri ato kryhen nga disa institute kërkimore-shkencore: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti i Historisë, Instituti i Kulturës Popullore, Qendra e Kërkimeve

Arkeologjike dhe Qendra e Studimit të Arteve. Një rol të rëndësishëm për dekada e ka luajtur dhe e luan Universiteti i Tiranës. Studime albanistike dhe albanologjike realizohen dhe në Universitetin e Shkodrës, në Universitetin e Elbasanit, në Universitetin e Korçës etj. Në Maqedoni studime albanologjike fillestare kemi pasur në degën e gjuhës shqipe të Fakultetit Filozofik të Shkupit, më vonë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Universitetin e Studimeve të Europës Juglindore, në Qendrën për Studime Shqiptare etj. Në Kosovë studime të tilla kanë nisur me Institutin Albanologjik (1953-1955, i rihapur më 1967), për të vazhduar në Universitetin e Prishtinës, në Institutin e Historisë, në Muzeun e Kosovës. Në botë ka disa qendra të studimeve albanologjike, kryesisht në formën e departamenteve universitare, ku mësohet shqipja. (Rexhep Ismajli)

ALEANCA BALLKANIKE (1912). Marrëveshje bilaterale e shteteve ballkanike, Bullgarisë, Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi për luftë kundër Perandorisë Osmane dhe për realizimin e synimeve pushtuese. Deri të arritja e aleancës ka pasur vështirësi të mëdha, për shkak të mosmarrëveshjeve rreth ndarjes së territoreve pas disfatës së ushtrisë osmane. Pas bisedimeve të gjata, më 13 mars 1912 u nënshkrua traktati i miqësisë dhe i aleancës ndërmjet Serbisë dhe Bullgarisë, që kishte edhe një "shtojcë sekrete", që ishte pjesa më e rëndësishme e tij. Sipas nenit të parë të asaj shtojce, Serbia dhe Bullgaria do të hynin bashkërisht në luftë kundër Portës, në rast se vinin në rrezik interesat e tyre kombëtare ose shtetërore, si dhe në rastet kur vihej në rrezik statuskuoja në Gadishullin Ballkanik. Neni i dytë i shtojcës sekrete shprehte hapur synimet aneksioniste të Serbisë ndaj tokave të banuara kryesisht me popullatë shqiptare. Sipas këtij neni, Serbisë i njihej e drejta mbi të gjitha tokat shqiptare që ndodheshin në veri dhe në perëndim të malit Sharr, kurse Bullgarisë e drejta mbi ato që ndodheshin në lindje të Rodopit dhe të lumit Strumica. Sipas këtij Traktati, Serbisë i siguroheshin territore të gjera shqiptare dhe, përmes tyre, dalje në detin Adriatik. Për zbatimin e marrëveshjes ishte garant perandori i Ruisë. Për këtë arsye, përmbajtja e traktatit serbo-bullgar u mbajt në fshehtësi dhe u bë publik me të gjitha detajet në shtypin francez në qershor të vitit

1913. Traktati serbo-bullgar vendosi bazat për krijimin e Aleancës Ballkanike. Për realizimin e planeve të veta pushtuese, Serbia u përpoq të bashkërendojë veprimet edhe me Malin e Zi. Gjatë vizitës së knjaz Nikollës në Beograd, më 1896, dhe në takimin e tij me mbretin Aleksandër në Cetinë më 1897, u diskutua ndarja e trashëgimisë turke, por një marrëveshje zyrtare nuk u arrit, sepse nuk u ra dakord se kujt do t'i takonte qyteti i Prizrenit. Përpjekja për marrëveshje ka pasur edhe më 1904 dhe më 1911, por pa sukses, për shkak të ndarjes së territoreve. Por marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi u arrit më 6 tetor 1912, ndërsa Bullgaria po ashtu arriti marrëveshje me Malin e Zi në shtator të vitit 1912, duke ia njohur të gjitha territoret që i pushtonte, pasi të fillonte luftën kundër Perandorisë Osmane. Edhe me Greqinë, pas shumë bisedimesh, në shtator të viti 1912, Serbia arriti marrëveshje, sipas të cilës vija e kufirit midis këtyre dy shteteve do të kalonte nga Liqeni i Ohrit e deri në Adriatik, gjë që përfundimisht do t'i jepej fund çështjes së autonomisë së Shqipërisë. Po ashtu, vend me rëndësi zë edhe marrëveshja sekrete ndërmjet Bullgarisë dhe Greqisë, e nënshkruar në maj 1912, por për shkak të mospajtimeve, ndarja e territoreve do të bëhej pas përfundimit të luftës. Në fillim të tetorit 1912, Aleanca Ballkanike filloi luftën kundër Perandorisë Osmane dhe brenda një kohe të shkurtër e shpartalloi atë në të gjitha frontet. Aleanca Ballkanike i mohoi plotësisht të drejtat e shqiptarëve dhe pushtoi e aneksoi pjesë të mëdha të territoreve me popullsi shqiptare. (Isa Bica)

ALEANCA DARDANO-ROMAKE. Marrëveshje e dardanëve me romakët në kuadër të koalicionit antimaqedon. Aleanca u krijua pas luftimeve me Maqedoninë dhe dardanët, duke u bërë pjesë e koalicionit antimaqedon, morën pjesë edhe në Luftën II Romake-Maqedonase. Koalicioni u lidh në vitin 200 p.e.r., kur Bato, djali i mbretit Longar, shkoi në llogoren e konsullit romak Galba, ku ishte dhe delegacioni i shtetit ilir dhe i atamanëve. Dardanët morën përsipër që së bashku me ushtrinë e shtetit ilir ta sulmonin Maqedoninë nga veriu, romakët nga lindja dhe etolët nga jugu. Nën presionin dardan, mbreti i Maqedonisë, Filipi V, u detyrua t'i dislokojë forcat ushtarake nga Pellagonia dhe t'u hapë dardanëve rrugë në drejtim të jugut. Në verë të vitit 197 p.e.r.

dardanët dominuan veriun e Maqedonisë, andaj Filipi V dërgoi 6,000 këmbësorë e 500 kalorës dhe, pas një lufte të rreptë, i mundi dardanët te Stobi. Pas vitit 197 p.e.r. dardanët ishin të pakënaqur me romakët, por i vazhduan sulmet kundër Maqedonisë dhe njëkohësisht u dhanë mercenarë etolëve në luftë kundër romakëve. Me gjithë këtë, në vitin 177 p.e.r. një delegacion dardan u paraqit para senatit romak dhe e akuzoi mbretin e Maqedonisë, Perseun, se planifikoi që t'i shfaroste dardanët përmes bastarnëve. Komisioni i senatit verifikoi se në Dardani bëhej luftë dhe e akuzoi Perseun për këtë, por nuk ndërmori asnjë hap për ta penguar. Si rezultat i mosveprimeve, në vitin 176 p.e.r. depërtuan në Dardani 30,000 bastarnë, të shoqëruar nga gra dhe fëmijë, por dardanët i tubuan forcat dhe i dëbuan. Aleanca dardano-romake, e mbështetur në interesa politike, dështoi me kohë dhe kulmoi me luftën e ashpër të viteve 75-73, të njohur si Lufta Dardane (Bellum Dardanica). Pas kësaj lufte të rreptë, Dardania ra në pozitë gjysmë të varur nga pushteti romak. (Edi Shukriu)

ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK). Parti politike në Kosovë e themeluar në vitin 2000. Në fillim AAK-ja ishte një koalicion i pesë partive. Në vitin 2001 dy nga partitë themeluese u tërhoqën, kurse në vitin 2002 AAK-ja u regjistrua si parti politike. AAK-ja është parti e qendrës së djathtë, me orientim proeuropian për një Kosovë demokratike, të pavarur dhe multietnike. Kryetar i partisë që nga themelimi është Ramush Haradinaj. AAK-ja deri në gjysmën e parë të vitit 2008 ka pasur sistem parlamentar të zgjedhjeve partiake, ndërsa pas kësaj kohe ndryshoi pjesërisht statutin e saj, duke futur sistemin presidencial të zgjedhjeve partiake në të gjitha nivelet. Në Kuvendin e Kosovës numri i mandatave të AAK-së ishte: 7 (2001-2004); 8 (2004-2008); 10+5 (2008-2010); 12+2 (2011). Së fundi AAK-ja është e përfaqësuar me 11 deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. (Nerxhivane. G. Dauti)

ALEANCA PËR KOSOVËN E RE (AKR). Parti politike në Kosovë e themeluar në vitin 2006. Është parti politike me orientim liberal-demokratik. Emërtimi i partisë politike Aleanca Kosova e Re rrjedh nga organizata për lobim, po me këtë emër në anglisht, "The Alliance for

New Kosova”, e themeluar nga Behgjet Pacolli në Uashington, për të lobuar për pavarësinë e Kosovës (2004-2006). AKR-ja mbajti kuvendin e parë zgjedhor më 26.11.2006, ku zgjodhi strukturat udhëheqëse të saj, me kryetar Behgjet Pacollin. Pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, AKR-ja u rendit ndër tri partitë politike kryesore në Kosovë, e përfaqësuar me 13 deputetë në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 AKR-ja nuk hyri në Kuvendin e Kosovës. (Nerxhivane G. Dauti)

ALIA Binak (1805-1895). Udhëheqës i kryengritësve malësorë në luftë kundër Perandorisë Osmane. Lindi në Bujan të Malësisë së Gjakovës. U dallua si njëri ndër udhëheqësit kryesorë në kryengritjet kundërosmane të periudhës 1840-1885. Është një nga figurat e shquara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që luajti rol të rëndësishëm në pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave midis familjeve dhe fiseve të hasmuara (Besëlidhja e Junikut, 1877). Bashkë me Shaqir Currin, Man Avdinë, Mic Sokolin, Smajl Mehmetin, Ali Ibrën etj., udhëhoqi luftërat e Krasniqes dhe të Malësisë së Gjakovës në kryengritjet dhe lëvizjet kundërosmane në vilajetin e Kosovës. Ishte i njohur edhe për interpretimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit në vilajetin e Kosovës e të Shkodrës. (Jusuf Bajraktari)

ALIA Muharrem (1921-1984). Veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. (LNDSH). Lindi në Pogradë të Gjiçanit. Pas vitit 1941 zhvilloi aktivitet kundër pushtetit bullgar, për çka u internua në Carevo Sello të Bullgarisë (1943-1944) bashkë me shumë bashkëfshatarë të tij. Pas kapitullimit të Bullgarisë u përfshi si vullnetar në luftimet që u zhvilluan kundër depërtimit e njësiteve të ushtrisë jugosllave në Kosovë. Me vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë, u mobilizua polic në Ranilluk dhe më pas në Shipashnicë. Në bashkëpunim me Rexhep Dajkofcin formoi komitetin e vendit të LNDSH-së në Pogradë. Përmes tij kontaktoi me Gjon Serreqin, i cili gjatë qëndrimit në Shipashnicë e rrethinë ishte në mbrojtje dhe në kujdesin e komandirit të milicisë Isa Dujakës dhe M. Alisë. Pas arrestimit të Gjon Serreqit (shkurt 1947), në mars arrestohet edhe M. Alia. Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi me 7 vjet burg. Pas daljes nga burgu, punoi murator. (Fehmi Rexhepi).

ALIBEGU Dilavere (1929-). Veterane e arsimit. Lindi në Ulqin. Shkollën fillore e nisi në vendlindje dhe e përfundoi në Shkodër. Arsimin e mesëm e filloi në Tiranë dhe më pas kreu kursin e lartë pedagogjik në Pejë (1950). Ishte mësuese në shkollën fillore të Ulqinit, pastaj në Mitrovicë, Stan-Tërg, Vushtrri dhe në Prishtinë. Qysh në fillim u angazhua edhe në kurse kundër analfabetizmit, kurse të shëndetësisë dhe amvisërisë, në shoqëri kulturo-artistike etj. Ishte vlerësuese dhe recensente e disa teksteve shkollore. Si mësuese e dalluar u nderua me mirënjohje dhe dekorata. (Fahri Buçinca)

ALIÇKAJ Kreshnik (1982-). Kompozitor. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë më 2001. Studioi në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe u diplomua në drejtimin teorik-pedagogjik (2005). Më pas u regjistrua në drejtimin e kompozimit dhe u diplomua më 2009 (te prof. M. Mengjiqi). Kreu studimet pasuniversitare në drejtimin e teorisë së muzikës, ndërsa më vonë ato të kompozimit te i njëjti pedagog. Nga viti 2007 u angazhua në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve, asistent për format muzikore dhe harmoni. Ka kompozuar një varg veprash korale: “Po këndon bilbili verës” (2007); solistike-instrumentale: “Dy për dy”, për flaut e piano (2005), “Something for Yu”, për piano 4-duarsh (2006), “Bona fide”, për violinë e piano (2008); vepra kamerale: Trio frymorë (2007), Kuartet harkor (2007), Furor musicum, për ansambël (2008) dhe veprat orkestrale: “Imo petore”, për orkestër harqesh (2008), Simfonia “Illiricum” (2009), Simfonia nr. 2 (2011) etj. (Besa Luzha)

ALIHAIJDARAJ Astrit (1976-). Aktor, skenarist, producent. Lindi në Istog. Nisi studimet për ekonomi e biznes në Vjenë (1999), por interpretimi në filmin e parë “Nordrand”, në regji të Barbara Albertit ia ndryshoi përcaktimin jetësor. Më pas studioi në Shkollën e Filmit në Vjenë, në degën e aktrimit. Interpretoi në filmat: “Kotva”, “Sonte është anuluar”, “Brendan Grant”, “Balkan Traffic”, “Dhoma e pianos” etj. Nga rolet teatrore veçohen ato në shfaqjet “Othello”, “Sirano de Berzherak” etj. Në produksionin e kinematografisë së Kosovës luajti në filmat: “Iliriana”, “Agnus Dei” etj. Është themelues dhe udhëheqës i produksionit filmik

“Illyria Film” në Kosovë. Është autor i dramës “Armendi dhe Vjena e tij”, që u shfaq në kuadër të festivalit “Roter Oktober” në Vjenë. (Gani Mehmetaj)

ALIMUSAJ Isa (1950-). Pikturor. Lindi në Strellc të Deçanit. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. U diplomua për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Kreu studimet e magjistraturës në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd më 1980. Ishte profesor i lëndës anatomi plastike në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Si pikturor u bë i njohur me ciklin “Profilet dardane”, që në krijimtarinë e tij artistike paraqet tërësinë më sublime tematike dhe estetike më të artikuluar. Ndër ekspozitat personale veçohen ato të organizuara në Prishtinë (1972), Prizren (1974), Beograd (1983), në Galerinë e Arteve të Kosovës (1987), Pejë (1988), në muzeun e Umagut (Kroaci) (1988), në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë (1993) dhe në Galerinë “Europa” në Pejë (1994). Mori pjesë në ekspozitat e përbashkëta të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës në vend e jashtë, në Sallonet Pranverore dhe në ekspozitat vjeshtore, në Biennalen e Vizatimit etj. Veçohet pjesëmarrja në ekspozitën “Artistët kosovarë” të organizuar në Beograd dhe Novi-Sad si dhe në Shtutgart. Është fitues i çmimit të Sallonit Pranveror më 1987 në Prishtinë. (Tahir Emra)

ALIMUSAJ Niman (1945-2009). Mbledhës i folklorit. Lindi në Strellc të Deçanit. Kreu studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi në shkollat e mesme të Deçanit dhe të Pejës dhe ishte edhe deputet i Kuvendit të Kosovës. Mbledhi lëndë folklorike, sidomos këngë të eposit të kreshnikëve nga lahtarët e shquar të anës së Deçanit dhe të Rugovës. Këngët e kreshnikëve të mbledhura nga ai u botuan në vëllimet “Këngë kreshnike” I dhe III (1974, 1993) në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Botoi librin “Nga lahuta e Dukagjinit, këngë kreshnike dhe balada” (2009), në të cilin janë përfshirë këngët e shënuara nga lahutari i njohur i Rugovës, Shaban Groshi. (Zymer U. Neziri)

ALISHANI Alajdin (1939-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, kurse

Fakultetin Juridik në Universitetin e Beogradit. Në vitin 1965 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik-Ekonomik të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në vitin 1971, ndërsa doktoroi më 1976 po në Fakultetin Juridik të Beogradit. Për lëndën e drejta e detyrimeve u zgjodh në të gjithë titujt universitarë. Pas largimit të studentëve dhe të profesorëve shqiptarë nga Fakulteti Juridik, në vitin 1991, vazhdoi të mbante mësim në gjuhën serbokroate. Botoi punime shkencore dhe libra nga fusha e marrëdhënieve të detyrimeve, përfshirë edhe tekstin universitar për këtë lëndë. (Nerxhivane G. Dauti)

ALITI Rafis (1956-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), politikan. Lindi në fshatin Radushë të Shkupit. Pas shkollës së mesme i filloi në Shkup studimet për kulturë fizike dhe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Punoi për shumë vjet si arsimtar në vendlindje. Në vitet ’80 u bë pjesë e lëvizjes ilegale, ndërsa më 1998-99 u përfshi në radhët UÇK-së në Kosovë. Në vitin 2000 u zgjodh anëtar i kryesisë së Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD). Më 2001 u bashkohet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, ku u emërua komandant i Brigadës 115, e cila veprroi në rajonin e Radushës së Shkupit. Pas formimit të Bashkimit Demokratik për Integritim, u bë pjesë e kësaj partie politike. Në periudhën 2002-2010 ishte nënkryetar i BDI-së. Më 2002 u zgjodh deputet dhe në mandatin e tretë (2008-2011) u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Është kryetar i degës së BDI-së për komunën e Sarajit në Shkup. (Fehari Ramadani)

ALIU Abdulla (1951-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Shipkovicë të Tetovës. Është mësimdhënësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP) që nga viti 1976, ndërsa që nga viti 2003 profesor i rregullt. Doktoroi në Fakultetin Juridik të UP-së, në fushën e së drejtës civile (1998). Kreu specializime edhe në Universitetin e Nicës dhe të Parisit II (1984/85), si dhe në Universitetin e Vjenës (1994). Për lëndët nga fusha e së drejtës civile botoi edhe tekstet universitare “E drejta civile” (2013), “E drejta sendore” (2004), “Burimet e së drejtës civile” (1999) etj. Kreu detyra të ndryshme me përgjegjësi në Fakultetin Juridik dhe në organet punëdrejtuese të UP-së

dhe të Universitetit të Prizrenit. (Nerxhivane G. Dauti)

ALIU Ali (1934-). Studiues i letërsisë, kritik letrar, profesor universitar, akademik. Lindi në Kranjë të Prespës. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në Manastir, ndërsa Shkollën



ALI ALIU

Normale në Tetovë dhe në Shkup, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Beograd. Ishte ndër studentët që themeluan “Përpjekjen”, shoqatën e studentëve shqiptarë në ish-Jugosllavi. Pas studimeve në Beograd punoi në redaksinë “Flaka e vëllazërimit” (1959-1969) në Shkup, ku botoi shkrime të shumta, reportazhe, komente etj. Në fund të viteve ’60 u zhvendos në Prishtinë, ku u punësua në Shtëpinë Botuese “Rilindja”, ndërsa nga viti 1972 u bë ligjërues në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1974 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Në fillim të viteve ’90 u përfshi në lëvizjet politike të kohës dhe ishte njëri nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa më pas ishte pjesë e institucioneve paralele të vendit dhe ndër veprimtarët e veshëm të lëvizjes për çlirimin e Kosovës. Viteve të fundit ligjëroi në Universitetin e Europës Juglindore dhe në Universitetin e Tetovës. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Pos punës si pedagog e publicist, A. Aliu për shumë vjet u mor me studime dhe kritike letrare. Krijimtaria e tij përfshin ese, studime letrare, monografi, përmbledhje kritikash letrare etj. Kultivoi frymën integrale në letërsinë shqipe, duke bërë të njohur për lexuesit si shkrimtarët e Kosovës, ashtu edhe të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. A. Aliu ka shkruar për shkrimtarët e afirmuar dhe për shkrimtarët e rinj, duke qenë vlerësuesi i parë i veprave të tyre. Vepra e tij është botuar dhe ribotuar nga disa shtëpi botuese në Kosovë, në Maqedoni dhe në Shqipëri. Disa nga veprat e tij janë: “Kërkime” (1971), “Shqyrtime” (1974),

“Rrjedhave të letërsisë” (1977), “Katër romane të Petro Markos” (1974), “Kritika” (1980), “Artikuj kritikë” (1983), “Ese letrarë” (1987), “Don Kishoti te shqiptarët” (1996), “Reflekse letrare” (1999), Magjia e fjalës” (2003), “Kronika letrare” (2003), “Don Kishoti shqiptar” (2005), “Miti ballkanik te Kadareja” (2007), “Dëshmi letrare” (2008), “Shtegtimi i metaforës” (2009), “Kënaqësia e leximit” (2012) etj. Ka hartuar disa antologji të poezisë shqipe, të cilat janë botuar në Prishtinë, në Tiranë dhe në Tetovë. Është autor tekstit mësimor “Teoria e letërsisë” (1985), pastaj “Si ta lexojmë poezinë” (2004) dhe bashkautor i tekstit “Letërsia bashkëkohore shqiptare” etj. Në vitin 2004, Shtëpia Botuese “Serembe” e Shkupit i botoi veprat e zgjedhura në katër vëllime. “Vepra “Don Kishoti” ndër shqiptarët është përkthyer dhe është botuar në maqedonisht, bullgarisht dhe anglisht. Për punën e tij krijuese mori çmime, dekorata dhe mirënjohje. (Fatmir Sulejmani)

ALIU Bekim (1965-). Gazetar i sportit. Lindi në Podujevë. Studimet i mbaroi për biologji në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Nisi karrierën sportive si futbollist me KF “Llapi”, duke fituar titullin e kampionit të Kosovës në edicionin 1982/83. Më pas iu përkushtua gazetarisë sportive, duke nisur me javoren “Sport plus” që nga viti 1997, pastaj si redaktor i sportit në të përditshmet “Kosova sot”, “Pavarësia”, “Iliria post”, “Lajm” dhe “Sport” dhe si gazetar në gazetën “Bota sot” dhe “Sport plus”. (Gani Kosumi)

ALIU Bislim (1946-). Piktur, kritik arti. Lindi në Podujevë. Kreu shkollimin në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1979). Mbaroi studimet pasuniversitare në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Hapi disa ekspozita personale në vitet 1972-1980 në Podujevë, më 1983 në Beograd, më 1986 në Grozhnjan (Kroaci), përsëri në Podujevë (1990-1995), më 1995 në Prishtinë, më 1996 në Podujevë dhe Prizren, më 1997, 2001 në Prishtinë, 2003 në Podujevë, më 2005, 2009, 2011 në Prishtinë në Galerinë e Ministrisë së Kulturës. Mori pjesë në ekspozita të përbashkëta të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës, si Salloni i Nëntorit, ekspozitat pranverore dhe vjeshtore dhe në Bienalen e Vizatimit, pastaj në

ekspozitat jashtë Kosovës, në Nish, Kragujevc, Luksemburg, Pogradec etj. Shquhen peizazhet autoktone, midis reales e modernës. Mori disa shpërblime e mirënjohje. (Tahir Emra)

ALIU Fitim (1975-). Piktore. Lindi në Prishtinë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Arteve po në Prishtinë. Për disa vjet ishte kryetar i Shoqatës së Artistëve Figurativë për rajonin e Gjilanit. Kreu disa udhëtime studimore për artin në Itali, Francë, Gjermani dhe Holandë, ku u njoh me rrjedhat më të reja në artet pamore, të cilat i ndihmuan t'i shpërfaqë me ndjesi në artin e tij. Hapi disa ekspozita personale në Prishtinë, Gjilan, Vernon (Francë) dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive. (Bislim Aliu)

ALIU Gëzim (1977-). Shkrimtar, studiues i letërsisë, kritik letrar. Lindi në Strofc të Vushtrrisë. Kreu shkollën fillore në Komoran, gjimnazin në Drenas, studimet për letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (2002), ku mbaroi dhe studimet pasuniversitare. Punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, pastaj gazetar dhe redaktor në revistën “Albanica” (2007-2010), kurse nga viti 2011 është punonjës shkencor në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Gjatë viteve 2010-2012 ishte redaktor përgjegjës në revistën “Jeta e re”. Ka marrë pjesë në konferenca për albanologjinë dhe ka botuar një mori tekstesh letrare, studimore, publicistike dhe eseistike në gazeta e revista. Ka botuar librin studimor “Diskurset e ideve në prozën e Kadarese” (2007), romanin “Në klubin e të shëmtuarve”, me të cilin ka fituar çmimin kombëtar për romanin më të mirë të vitit 2009 nga Ministria e Kulturës e Kosovës. Ka botuar edhe përmbledhjen me tregime “Libri i fundit” (2012) dhe romanin “Katedralja pa kryq” (2014). Pjesë të krijimtarisë së tij letrare janë përkthyer dhe botuar në revista letrare jashtë vendit. (Agron Gashi)

ALIU Hafiz Avni (1947-2011). Titullar i fesë islame, publicist. Lindi në Tërnoc të Madh të Bujanocit. Mësimet e para i mori në vendlindje dhe i vazhdoi në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë (1978). Punoi si sekretar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan dhe imam në xhaminë e fshatit Livoç i Epërm dhe më pas

në Xhaminë “Atik” të Gjilanit. Për tri mandate ishte kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan. U mor aktivisht me publicistikë dhe ishte bashkëpunëtor i rregullt i periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës. Shkrimet e tij u botuan edhe në Tiranë, Shkup, Podgoricë, Sarajevë etj. Ka botuar disa monografi dhe vepra fetare: “Jasini në gjuhën shqipe” (1994), “Të njohim Islamin” (1997), “Myderriz Haki efendiu, një jetë për fe e atdhe” (2005) etj. (Qemajl Morina)

ALIU Harun (1971-2010). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Gjatë luftës ishte i njohur me nofken komandant “Kushtrimi”. Lindi në Hasanbeg të Shkupit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Damask të Sirisë. Studimet për histori i nisi në Universitetin e Tetovës (1994). Në vitet 1995-1998 i bashkohet lëvizjes ilegale ushtarake. Në vitin 1998 autoritetet maqedonase organizuan në mungesë procesin gjyqësor kundër “bombahedhësve të Kërçovës”. Ai u largua në Shqipëri dhe atje u angazhua për rekrutimin e të rinjve shqiptarë nga Maqedonia në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte ndër themeluesit e UÇK-së në Maqedoni dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të saj. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit u burgos nga policia e UNMIK-ut në Kosovë dhe u dënua me 4 vjet burg. Më 2006, pas daljes nga burgu, themeloi subjektin politik Alternativa Kombëtare. Në vitin 2008 autoritetet maqedonase e akuzuan për vrasjen e një polici të njësisë speciale “Tigrat” dhe e dënuan në mungesë me burgim të përjetshëm. Për t'i shpëtuar burgut, u largua jashtë vendit. Më 12 maj të vitit 2010 u vra në afërsi të fshatit Radushë të Shkupit, në rrethana të pasqaruara. (Fehari Ramadani)

ALIU Mustafë (1949-). Mësimdhënës universiteti. Lindi në Gadime të Ulët të Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Lipjan. Kreu Fakultetin e Edukatës Fizike dhe të Sportit në Universitetin e Sarajevës, më pas magjistroi në shkencën e kineziologjisë në Universitetin e Zagrebit, kurse disertacionin e doktoratës e mbrojti më 1991 në Sarajevë. Pas studimeve një kohë punoi në gjimnazin e Lipjanit, ndërsa më vonë ishte këshilltar pedagogjik në Entin Ndërkomunal të Arsimit në Ferizaj. Në vitin 1979 u zgjodh asistent në Fakultetin e Kulturës

Fizike në Prishtinë. Tri herë u zgjodh dekan i këtij Fakulteti. Ligjëroi lëndët: psikomotorikë, kineziologji dhe gjimnastikë sportive. Që nga viti 2006 është profesor i gjimnastikës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sportit në Prishtinë. Ka botuar një varg punimesh shkencore në shumë gazeta dhe revista në Kosovë dhe jashtë saj. (Lulzim Shala)

ALIU Sylejman (1947-). Shkrimtar, publicist. Lindi në fshatin Kashtanjevë të Ferizajit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Ferizaj, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Punën në gazetari e filloi që herët në gazetën e studentëve të UP-së, “Bota e re”, ku ishte edhe kryeredaktor (1972-1974). Më pas punoi si gazetar në gazetën “Rilindja”, më pas redaktor në njësinë e revistave të “Rilindjes”. Së fundi është botues i Shtëpisë Botuese “Saga”. Në fillimet e karrierës së tij artistike u mor më shumë me tregime dhe novela, ndërsa më vonë botoi dhe zhanre të tjera, si drama, romane, poezi dhe publicistikë. Shkroi dhe botoi këto përmbledhje me tregime dhe novela: “Shtëpia në pluhur” (1978), “Fillimi i vjeshtës” (1980), “Gjuetari i dehur” (1987), pastaj dramat: “Trazimi i heshtjes” (1994), “Vdekësit e popullit” (1998), “Kupola e lumturisë: Magjia e mashtrimit” (2011), romanin “Muzgu i bardhë” (2003), librin publicistik “Filozofia e krrokamës” (2009) dhe përmbledhjen me poezi “Stina e lotit” (2014). (Adil Olluri)

ALIU-TAHIRI Lindita (1963-). Poete, gjuhëtare, studiuese e letërsisë, mësimdhënëse universitare. Lindi në Shkup, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për gjuhë



LINDITA
ALIU-TAHIRI

dhe letërsi angleze i ka kryer në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më pas ka kryer studimet pasuniversitare dhe doktoratën (2006) në fushën e stilistikës. Një pjesë të studimeve pasuniversitare i ka kryer në Universitetin e Anglisë Lindore (1985) dhe gjatë vitit 1986/87 ka studiuar në programin master në Universitetin e Çikagos. Ka punuar në fjalorin anglisht-shqip të Njumarkut në Universitetin e San Diegos gjatë viteve 1988 dhe

1989 dhe gjatë vitit akademik 2010/11 ka bërë studime hulumtuuese në Universitetin Marilend në SHBA. Është mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës që nga viti 1984. Ka botuar libra dhe studime në fushën e gjuhësisë kritike, të kritikës letrare, të stilistikës dhe të analizës së diskursit. Analiza gjuhësore e veprës së Kadaresë në punimin e saj të magistraturës, një pjesë e së cilës është botuar më 2009 (“Rrëfimi impersonal i Kadaresë”), është ndër punimet e para të këtij lloji në studimet e shqipes. Më 2013 në Tiranë ka botuar përmbledhjen e punimeve “Gjuha dhe lufta e ideve”, ku objekt studime është letërsia dhe diskursi medial. Interesim i saj në fushën e letërsisë është edhe shpërfaqja e treguesve gjuhësorë të mendimeve dhe ndërrijes të personazheve në raport me zërin rrëfyes, gjë që trajtohet në librin “Monologu, personazhi dhe autori” (2006). Ka përkthyer në shqip autorë si Konrad, Vulf, Heminguej, Golding, Dickinson, Le Guin etj. Është autore e dy librave të poezisë, “Mure” (1984) dhe “Ndoshta do të ishin më të mëdhenj”(1990). Poezitë e saj janë botuar edhe në gjuhë të huaja. (Lindita Rugova)

ALOJA Mehmet (1943-). Piktore. Lindi në Ulqin. Mbaroi shkollën e mesme në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Nikshiq (1969). Kreu Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës më 1984. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve të Malit të Zi dhe anëtar i Shoqatës Gjithëshqiptare të Arteve Figurative në Tiranë. Hapi ekspozita personale në Prishtinë (1971 dhe 2008), në Ulqin (2003 dhe 2009) etj. dhe mori pjesë në ekspozitat kolektive në Dubrovnik, Ulqin, Cetinje, Shkodër, Tiranë dhe Vjenë. Është piktor i peizazhit dhe i natyrave të qeta, vepra këto të trajtuara në frymën realiste me primesa të lirizmit poetik dhe ekspresiv. Është arsimtar i artit figurativ në Shkollën e Mesme në Ulqin. (Rexhep Ferri)

ALPINIZMI (BJESHKATARIA). Ngjitje në male të larta, me qëllim të zbulimit dhe të përjetimit të bukurive natyrore. Shoqëria e parë bjeshkatore alpine e organizuar në Kosovë ishte “Gjeravica” nga Peja, e cila u themelua në vitin 1928. Themelimi i shoqërive të tjera bjeshkatore vazhdoi pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1951 themelohet Këshilli Krahinor i Bjeshkatarisë, i cili më vonë shndërrohet në Lidhjen Bjeshkatore-Skitare të Kosovës. Shoqëria më aktive ishte “Gjeravica”



NJË EKSPEDITË E ALPINISTËVE TË KOSOVËS

nga Peja. Gjatë periudhës 1956-1967 publikoi 19 numra të revistës “Zëri i Gjeravicës” si dhe hartën bjeshkatore “Alpet Shqiptare”. Në Kosovë vepruan edhe këto shoqëri bjeshkatore alpine: “Pashtriku” (tash “Sharri”, Prizren 1948), “Gërmia”, (tash “Prishtina 1”, Prishtinë 1948), “Pashtriku”, (Gjakovë, 1948), “Sharri”, (tash “Lyboteni”, Ferizaj, 1948), “Trepça”, Mitrovicë, 1948, është shuar), “Çiçavica”, Vushtrri, 1950, është shuar), “Zhelezniçar” (tash “Kalaja”, Fushë-Kosovë, 1967), “Eko”, Prizren 2000, është shuar), “Guri i zi” (Dragash, 2000), “Blinaja” (Lipjan, 2000), “Guri i shtrenjtë” (Shtime, 2004), “Shkëlzeni” (Gjakovë, 2004), “Dardania” (Gjilan, 2008). Këto shoqëri kanë organizuar ecje, pushtime, trajnime në alpinizëm, shpëtimtari, speleologji, shënim të shtigjeve në bjeshkë, orientim në harta dhe busulla, biatlion, ruajtjen e ambientit dhe ruajtjen nga vendet e minuara. Kanë organizuar takime ndërkombëtare me shoqëri të ndryshme nga vendet e rajonit dhe më gjerë. Federata Bjeshkatore-Alpine e Kosovës u pranua në Unionin Ndërkombëtar të Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes më 2011, në kuvendin e mbajtur në Katmandu të Nepalit. (Xhavit Kajtazi)

ALTARI I ESKULAPIT, TELESFORIT, HIGISË. Monument epigrafik i zbuluar në Prizren. Është punuar në mermer me teknikë relievi dhe i takon shek. II. Mbishkrimi është në gjuhën latine kushtuar triadës së perëndive: Eskulapit, Telesforit e Higisë dhe dy gjenive,

Dolihenit dhe Gjenit të kohortës. Eskulapi me mjekër të theksuar gjendet në pjesën e majtë, me qëndrim frontal dhe këmbë të djathtë të lakuar. Është i veshur me himation dhe në dorën e djathtë mban shkopin me gjarpër të ndërthurur, ndërsa të majtën e ka të lakuar dhe të vendosur në ije. Në pjesë qendrore gjendet Telesfori (gjeniu i vogël), ndërsa në të majtë Higia. Telesfori është i mbuluar me pëlhurë të gjatë dhe kësulë të mprehtë, ka qëndrim frontal dhe këmbë të puthitura. Higia, e bija e Eskulapit dhe hyjneshë e shëndetit dhe e pastërtisë, ka qëndrim frontal, shputa të zbuluara dhe është e veshur me himation të gjatë. Koka e Higisë është plotësisht e dëmtuar, bashkë me pjesën e epërme të altarit. Në dorën e djathtë mban gjarpurin, ndërsa me të majtën e ushqen atë. (Arianit Buçinca)

ALTARI I ESKULAPIT. Monument epigrafik i zbuluar në Prizren. Është punuar në mermer dhe daton nga mesi i shek. III. Eskulapi, hy i mjekësisë, paraqitet në pjesën qendrore të altarit, në relief figurativ, me flokë të gjatë dhe i veshur me himation të gjatë. Gjoksin e ka të zbuluar dhe është i mbështetur në shklop me gjarpër të ndërthurur në të. Mbishkrimi është në gjuhën greke dhe i kushtohet Eskulapit me epitelin “soter” (shpëtuesi) nga dedikuesit me prejardhje nga Azia e Vogël. (Arianit Buçinca)

ALTERNATIVA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (ADK). Parti politike e themeluar në vitin 2004 nga një grup ish-anëtarësh të LDK-së, më në krye Edita Tahirin, Edi Shukriun, Agim Hysenin, Mentor Aganin, Rexhep Osmanin etj. Që nga themelimi i saj partia udhëhiqet nga Edita Tahiri. Është e deklaruar si parti e demokracisë liberale. Ishte e përfaqësuar në Qeverinë e Kosovës përmes kryetares së partisë (2011-2014). Në zgjedhjet e deritashme parlamentare ADK-ja nuk ka arritur të përfaqësohet në Kuvendin e Kosovës, apo në nivel komunal, por ka qenë pjesë e koalicionit me PDK-në. (Iilir Dugolli)

ALTIMARI Françesko (Francesco) (1955-). Filolog, albanolog, profesor arbëresh. Lindi në Shën Mitër në Kalabri. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Kalabrisë, ku më 1980 e nisi karrierën akademike: profesor i Universitetit të Kalabrisë, shef katedre në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Institutit




FRANÇESKO
ALTIMARI

Universitar Lindor të Napolit (1991). Nga viti 1992 profesor në Universitetin e Kalabrisë, ku vijoi veprimtarinë didaktike-shkencore dhe ushtron përgjegjësi institucionale akademike. Është studiues i letërsisë arbëreshe dhe shqipe të Rilindjes, i dialektologjisë arbëreshe dhe i filologjisë shqiptare. Zbaton metoda të kritikës gjenetike dhe të filologjisë informatike. Është bashkërendues shkencor i Arkivit Leksikografik Arbëresh (AleA), i projekteve “Besa”, “Vatra” dhe drejtues i doktoranturës ndërkombëtare në albanologji (2002). Botoi: “Studime mbi letërsinë shqiptare të Rilindjes” (1984); “Ekzili i fjalës - Minoriteti gjuhësor arbëresh në Itali” (bashkautor) (1986); “Dialektet italo-shqiptare” (bashkautor) (1994); “‘Bagëti’ e Bujqësija e Naim Frashërit”, botim kritik me konkordanca leksikore (1995); “Këngët paramilosaoiane të G. De Radës”, botim kritik me konkordanca leksikore (1998, 2005); “Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe” (2002) etj. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i botoi përmbledhjen e studimeve “Studime gjuhësore italo-shqiptare” (Studia linguistica italo-albanica) më 2014. Ka themeluar kolanën “Albanistica” (1990) në Universitetin e Kalabrisë dhe drejton kolanën “Opera omnia” të J. de Radës. Është shpallur “Doctor honoris causa” i Universitetit të Tiranës (2007) dhe i Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë (2013) dhe është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2006) dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2008). (Aljula Jubani)

ALTINI. Emër i një rajoni në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna. Përmendet në krisobulat e Deçanit të vitit 1330 dhe në defterë osmanë të regjistrimit të shek. XV-XVI. Nga përshkrimi i kufijve “të gjithë Altinit”, që jepet në këtë burim, nuk merret vesh se cilat vendbanime dhe bjeshkë përfshinte kjo krahinë, sepse në tekstin përkatës përmenden vetëm mikrotoponime, midis të cilave ishte edhe një vend i quajtur Altin. Më saktësisht për hapësirën e Altinit mësohet nga të dhënat e regjistrimit të vitit 1485 të sanxhakut të Shkodrës, kur Altini ishte nahije e veçantë, e krijuar që në vitin 1477. Atëbotë Altini përfshinte 55 katunde dhe 2

truallishta që shtriheshin në trekëndëshin midis Tropojës, Junikut dhe Gjakovës, e njohur ndryshe si Malësia e Gjakovës. Si edhe e gjithë hapësira etnolinguistike shqiptare, Altini banohej nga popullata vendëse. Kjo shihet edhe nga fakti se kisha dhe pushteti rasian i Nemanjidëve ua ndalonin “arbanasve” dhe vllahve kullotjen e bagëtisë në bjeshkët e Altinit dhe se ai pushtet e njohu të vlefshëm edhe një ligj/kod të mëvetësishëm të shqiptarëve, përkatësisht “ligjin e altinasve”, që është më i moçëm se koha e pushtimit rasian të tokave shqiptare në gjysmën e parë të shek. XII. Emri i kësaj krahine rrjedh nga mbiemri latin *altus* (i lartë, i rritshëm për nga shtati) dhe shënjon hapësirë malesh të larta. Duket se në zonën e Rrafshit të Dukagjinit ishte së pakut edhe një mal tjetër i quajtur Altin, sepse në krisobulën serbe të viti 1348 në periferi të katundit Piranë të Prizrenit përmendet një lum i quajtur *al'tunica*, vendburimi i të cilit do të ketë qenë në një mal të quajtur Altin. (Skënder Gashi)

ALLAJBEGU Muntas (1946-2014). Trajner i mundjes. Lindi në Dibër. Ka nxjerrë shumë mundës të njohur, ndër të cilët edhe kampionin olimpik Shaban Tërstena dhe fituesin e medaljeve olimpike, Shaban Sejdiun. Dha një kontribut të madh në klubin e mundjes “Liria” të Shkupit. Nisi punën si trajner i mundjes që kur ishte arsimtar i edukatës fizike në shkollën “7 Marsi” në Dibër, ku krijoi seksionin e mundjes,



MUNTAS
ALLAJBEGU

prej nga doli edhe kampioni i parë, që ishte 15-vjeçari Ekrem Sulejmani, kampion i ish-Jugosllavisë për të rinj në vitin 1966. Prej viteve ‘70 punoi në klubin e mundjes “Skopje”. Ndërkohë, në shkollën fillore “Liria”, ku punoi si arsimtar, hapi 9 seksione të sportit, si: mundje, basketboll, hendboll, futboll etj. Në vitin 1977 u formua klubi i mundjes “Liria”, ku bërthamën e përbënin mundësit e ushtruar nga Allajbegu. Ndërkohë, me ardhjen e tij në postin e trajnerit të klubit të mundjes “Prishtina”, më 1983 filloi edhe puna e mirëfilltë e Federatës së Mundjes së Kosovës, të cilën Allajbegu arriti ta themelojë pas shumë peripecive. Përveç që ishte trajner i këtij klubi, Allajbegu rregullisht shkonte edhe në qendra të tjera të Kosovës,

ku punonte me trajnerët e klubeve të tyre, si në Prizren, Mitrovicë, Han të Elezit, Vushtri, Ferizaj, Skënderaj dhe Dragash. M. Allajbegu është meritore për popullarizimin e sportit të mundjes në hapësirat shqiptare. (Tahir Sopi)

AMBASADAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës në botë, të themeluara sipas Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008 janë themeluar dhjetë përfaqësitë e para diplomatike të Kosovës: në Ankara, Berlin, Bern, Bruksel, Paris, Pragë, Romë, Uashington, Vjenë dhe Tiranë, ndërsa gjatë vitit të parë të funksionimit të tyre janë udhëhequr nga të Ngarkuarit me Punë. Në gjysmën e dytë të vitit 2009 u përmyll procesi i emërimit të ambasadorëve të parë të Republikës së Kosovës dhe është zgjeruar rrjeti i ambasadave, duke vendosur praninë diplomatike edhe në Budapest, Hagë, Lubjanë, Riad, Shkup, Sofje, Stokholm, Tokio e Zagreb. Gjatë viteve pasuese janë hapur edhe tri ambasada (Kanbera, Panama City dhe Podgoricë) duke u bërë kështu gjithsej 22 ambasada të Republikës së Kosovës. (Ilir Dugolli)

AME Dritëro (1978-). Aktor. Lindi në Dibër, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për aktrim në Universitetin e Tetovës. Projektet më të rëndësishme ku aktroi janë: “Martesa” (1999), “Mbreti Gent” (2000), “Pas vdekjes” (2000), “Duke pritur Godonë” (2001), “Stjuardesa” (2003), “Fqinjët” (2005), “Shërbëtorët” (2006), “Pazar me djallin” (2007), “Njerëz dhe minj” (2007), “Shtëpia në kufi” (2009), “Impresario nga Izmiri” (2010), “Me grusht tehut të thikës” (2011), “Opera e lypsareve” (2012), “Personi i dyshimtë” (2014) etj. Luajti në filmin e metrazhit të gjatë “Lufta mbaroi”. U dëshmuar edhe si udhëheqës emisionesh argëtuese në televizion. Është aktor i Teatrit Shqiptar në Shkup. (Salajdin Salihu)

AMENDAMENTET NË KUSHTETUTËN E RSFJ-së (1968-1971). Ndryshimet në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1963, me të cilat u zgjeruan kompetencat autonome të krahinave socialiste autonome (KSA), përfshirë edhe të Kosovës. Ato erdhën si rrjedhojë e kërkesave të popullit të Kosovës dhe e demonstratave të

vitit 1968 për barazi në ish-Jugosllavi dhe për status më të avancuar të Kosovës në Federatën Jugosllave. Atëbotë ishte krijuar grupi punues për të parashtruar kërkesat përmes grupeve punuese për përmirësimin e pozitës juridike institucionale të Kosovës, karshi një Kushtetute (1963), e cila kishte nënvlerësuar objektivat e popullatës shumicë në Kosovë, me ngushtimin e autorizimeve juridike, politike, ekonomike, kulturore e shkencore. Kjo ishte koha e qeverisjes dhe mbisundimit të ish-Jugosllavisë nga forcat reaksionare, nacionaliste dhe shoviniste serbe (nën Rankoviqin). Amendamentet VII dhe VIII në tërësi i referoheshin pozitës së njësive autonome. Në amendamentin VII përcaktohej se RSFJ-në e përbejnë gjashtë republika dhe dy krahina, KSA e Kosovës dhe KSA e Vojvodinës edhe brenda RS të Serbisë. Pra, Kosova me këto amendamente nuk u bë njësi konstitutive e ish-Federatës Jugosllave deri në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974. (Osman Ismaili)

AMENDAMENTET NË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2012). Ndryshimet e para të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pas miratimit të saj në vitin 2008, si rezultat i procesit të përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. Në shtator të vitit 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi 22 amendamente kushtetuese, me të cilat i dha fund mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Amendamentet përfshinin ndryshimin e formulës së votimit të legjislacionit me interes vital, eliminimin e supremacisë kushtetuese të “Pakos së Ahtisarit” ndaj Kushtetutës, amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht vazhdimësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të aplikueshëm, dispozitave përfundimtare, duke përfshirë edhe mekanizmat dhe proceset politike lidhur me to etj. (Arsim Bajrami)

AMENDAMENTET NË KUSHTETUTËN E RS TË SERBISË (1989). Është hapi i parë institucional, me të cilin Serbia filloi procesin e rrënimit kundërkushtetues të pozitës së Kosovës, të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Në kundërshtim me vullnetin politik të popullit shqiptar të Kosovës, Kuvendi i Serbisë ia arriti që (sipas interpretimit serb) të marrë pëlqimin nga Kuvendi i Kosovës dhe më 23 mars të vitit 1989 të miratojë amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1974. Nga

gjithsej 41 amendamente kushtetuese, 8 prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohen pozitës së njësisve autonome, përkatësisht zgjerimit të funksioneve unike të organeve republikane të Serbisë mbi krahinat. Veprimet kundërkushtetuese të Kuvendit të Serbisë të vitit 1989 u materializuan përmes Amendamenteve: XXVII, XXIX, XXXI, XXXIII, XL, XLIV, XLVII. Amendamenti XXVII kufizonte të drejtat e njësisve autonome në sferën e rregullimit ligjor të përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të kombeve dhe kombësive në territorin e njësisve autonome. Amendamenti XXIX zgjeroi kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, ashtu që kjo gjykatë autorizohet të vlerësojë pajtueshmërinë e kushtetutave të njësisë autonome me Kushtetutën e Serbisë. Amendamenti XXXI përcaktonte raporte të reja midis organeve republikane dhe atyre krahinore në sferën e zbatimit të ligjeve unike republikane, që janë aplikuar në tërë territorin e Serbisë. Funksionet unike të RS të Serbisë, që janë realizuar në vëllim dukshëm më të zgjeruar janë përcaktuar në Amendamentin XXXIII. Ky amendament zgjeroi funksionet unike të Republikës në sferën e përdorimit të simboleve kombëtare, të përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të kombeve dhe të kombësive, të përdorimit të flamujve kombëtarë, në sferën e mbrojtjes popullore dhe të sigurimit shtetëror, mbrojtjes penalo-juridike të qytetarëve etj. Në amendamentin XL ishin përcaktuar zgjidhjet e reja në përfaqësimin e njësisve autonome në organe të Republikës së Serbisë. Sipas këtij amendamenti përcaktohej se në realizimin e politikës kadrovike në organet e Republikës do të merrej parasysh përfaqësimi i kombeve dhe i kombësive nga territori i Republikës si tërësi. Në vend të përfaqësimit të njësisve autonome, ky amendament aplikonte parimin e përfaqësimit të kombeve dhe kombësive që jetojnë në njësitë autonome. Me amendamentin XLIV zgjeroheshin kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligshmërisë së akteve dhe dispozitave të përgjithshme juridike, për të cilat është konstatuar se janë në kundërshtim me Kushtetutën e RS të Serbisë, me ligjet unike republikane dhe me dispozitat e aktet e tjera të përgjithshme, që i nxjerrin organet republikane dhe që aplikohen në mënyrë unike në tërë territorin e Republikës. Me amendamentin XLVII ishte përcaktuar procedura e re për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë, me çka përjashtoheshin njësitë autonome të vendosnin për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë dhe

eliminimin e mundësisë që ato të bllokojnë procesin e ndryshimeve kushtetuese në Serbi. (Arsim Bajrami)

AMETI Reshat (1964-). Piktur. Lindi në Gostivar. Kreu Shkollën e Mesme të Artit dhe Fakultetin e Artit Figurativ në Shkup. Nga viti 1995 është mësimdhënës në Universitetin e Shkupit, ndërsa nga viti 2008 edhe në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Tabloja e R. Ametit shquhet me elementet e abstraksionit gjeometrik dhe lirik, me gjallërinë dhe harmoninë koloristike. Në veprën e tij ndeshim tri cikle kryesore: “Nga tradita”, “Vrutoku” dhe “Gjeometrizmi lirik”, të frymëzuar nga folklori shqiptar. Është pjesëmarrës në shumë koloni artistike dhe ka realizuar disa ekspozita personale jashtë vendit, si në Hamburg, Nju-Jork, Ankara, Cyrih, Bruksel, Sofje, Vjenë etj. Veprat e tij janë prezantuar edhe në galeritë e Maqedonisë, Kosovës dhe të Shqipërisë. Është fitues i çmimeve profesionale dhe i mirënjohjeve publike: çmimi “11 Tetori” për vepër jetësore, çmimi për pikturë “Llazar Liçenovski” etj. (Jëldeze Asani)

AMITI Burhan (1977-). Aktor. Lindi në Gillogjë të Tetovës, ku kreu shkollën fillore. Shkollën e mesmen e kreu në Tetovë, studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Realizoi një sërë rolesh në teatër dhe film. U shqua në shfaqjet: “Maturantët”, “Lavrja e denjë për respekt”, “Çmendina”, “Duke pritur Sarën”, “Hamleti i mëhallës sonë” etj. Aktroi në filmin “Pëshpëritje” të A. Thaçit dhe në serialin “Maqedonia në zemrën time”. Është aktor në Teatrin e Tetovës. (Salajdin Salihu)

ANADRINI. Trevë gjeografike në Rrafshin e Dukagjinit, që shtrihet përgjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë, prej Urës së Fshejtë deri te gryka e Nashecit (në perëndim të Prizrenit). Përgjatë Anadrinisë kalon rruga automobilistike dhe hekurudhore (Prizren-Pejë-Prishtinë). Në aspektin gjeologjik përbëhet nga sedimente të reja (argjilë, rërë, zhavorre). Relievi është kryesisht i rrafshët, i pjerrtësuar në drejtim të Drinit të Bardhë. Klima është kontinentale, me ndikime të klimës mesdhetare, me temperaturë mesatare vjetore 11°C, kurse reshjet mes 800-1000 mm. Pjesa më e madhe e tokave janë sipërfaqe të punuara bujqësore (mbi 50%), kurse pjesa tjetër me pyje e kullota. Relievi i përshtatshëm, klima me ndikime

mesdhetare kanë mundësuar zhvillimin e vreshtarisë dhe perimtarisë. Pjesa më e madhe e vendbanimeve janë të tipit rural, kurse në skaj të Anadrinisë është i vendosur qyteti i Rahovecit (15,892 banorë), si qendër agrare me funksione arsimore, shëndetësore, prodhuese etj. (Valbon Bytyçi)

ANALFABETIZMI. Analfabetizmi ishte një problem i theksuar në Kosovë. Pas Luftës së Dytë Botërore, 80% e popullsisë kosovare nuk dinin lexim-shkrim. Shumë më i theksuar ishte analfabetizmi te popullsia shqiptare. Numri i femrave shqiptare që dinin lexim e shkrim ishte i papërfillshëm. Në vitet 1945-1952 u bënë përpjekje për tejkalimin e kësaj prapambetjeje. U organizua një fushatë e gjerë kundër analfabetizmit, u organizuan kurse dhe forma të tjera kundër këtij fenomeni, ku u përfshinë me mijëra burra dhe gra. Për arsimin fillor të të rriturve u angazhuan jo vetëm shkollat fillore, por edhe institucione të tjera. Megjithatë, përqindja e popullsisë analfabete në Kosovë mbeti gjithnjë e madhe. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1971, Kosova kishte 31.5% të popullsisë (mbi moshën 10-vjeçare) analfabete. Rreth gjysma e popullsisë, sidomos ajo shqiptare, ishte pa shkollë. Përpjekjet kundër analfabetizmit vazhduan sidomos nëpërmjet përfshirjes masive të fëmijëve të moshës shkollore në arsim të detyrueshëm dhe kufizimit të mundësive për analfabetë të rinj. Për arritjet e këtyre përpjekjeve dëshmon fakti se në vitin 1981 numri i analfabetëve bie për 13%, në krahasim me dhjetë vjet më parë (popullsia analfabete në Kosovë ishte 17.6%). Institucionet shtetërore dhe faktorët e tjerë shoqërorë vazhduan përpjekjet kundër kësaj dukurie. Në vitin 1982 u miratua “Ujdia shoqërore për mësimin e shkrim-leximit dhe shkollimin e të rriturve”, me të cilën parashikohej që në forma të mësimin të shkrim-leximit të përfshihej tërë popullsia analfabete në Kosovë, deri në moshën 45-vjeçare. Planifikohej t’i jepej fund analfabetizmit deri në fund të shek. XX, mirëpo ky objektiv nuk u realizua. Kosova mbeti gjithnjë shumë prapa në krahasim me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Për më tepër, pas vitit 1981 numri i analfabetëve shqiptarë në Kosovë rritet. Derisa në vitin 1981 në Kosovë kishte 196,000 analfabetë, në vitin 1991 ky numër shkon në mbi 250,000. Analfabetizmi vijon të jetë i pranishëm ende, sidomos në radhët e grave në zonat rurale.

Shumë më e madhe është përqindja e analfabetëve funksionalë. (Demë Hoti)

ANAMALI Skënder (1921-1996). Njëri nga themeluesit e arkeologjisë shqiptare, studiues i shquar i arkeologjisë dhe i historisë antike të Shqipërisë. Lindi në Shkodër, ku kreu shkollën



SKËNDER
ANAMALI

e mesme, ndoqi studimet në Fakultetin e Letërsisë e të Filozofisë në Universitetin e Padovës (Itali). Filloi punën si arkeolog në Institutin e Shkencave në Tiranë (1947) dhe bashkë me H. Cekën hapën muzeun e parë arkeologjik (1948). Ndërmori gërmime të pavarura në qytetin e Amanties, në Apoloni dhe në Durrës. Problemet historiko-arkeologjike të kulturës së arbërve të hershëm u bënë objekt i hulumtimeve të tij gjatë gjithë jetës. Bëri gërmime sistematike në varrezën mesjetare të Krujës, të Komanit, të Buklit, të Shurdhahut, në bazilikat e Linit dhe të Ballshit, në kalanë e Pogradecit, në kalanë e Stelushit etj. Rezultatet shkencore të gërmimeve u pasqyruan në një sërë artikujsh e studimesh të botuara edhe jashtë vendit, ku përcakton përbërësit e kulturës arbërore, procesin e lindjes dhe të zhvillimit autokton të bartësve të saj. Është autor i monografisë për qytetin e Amanties, bashkautor në veprat “Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë” (1965), “Historia e Shqipërisë” I (1959), “Historia e popullit shqiptar” I (2002); “Corpus des inscriptions latines d’ Albanie” (Korpusi i mbishkrimeve latine në Shqipëri, Romë, 2009) dhe autor i vëllimit “Nga ilirët te shqiptarët” (Des Illyriens aux Albanais, Tiranë, 2011). Ishte anëtar i “Shoqatës Ndërkombëtare për Epigrafi Greke dhe Latine” me seli në Paris. (Luan Perzhita)

ANAMORAVA. Trevë gjeografike në lindje të Kosovës. Shtrihet ndërmjet zonës kodrinore-malore të Novobërdës dhe Gollakut, në veri, dhe Karadakut të Shkupit, në jug. Individualiteti gjeografik i kësaj treve përcaktohet nga rrjedhja e Moravës së Binçës. Përmes grykës së Konçulit lidhet me Bujanocin, ndërsa përmes Qafës së Muçibabës me Preshevën. Dominon relievi i rrafshët me lartësi mbidetare prej 450-500 m. Prej lokalitetit Sadovinë e Çerkezëve

deri te Hodonoci është e gjatë 40 km, kurse gjerësia më e madhe është ndërmjet Vitisë dhe Gjilanit. Me 273 km², ajo është rreth pesë herë më e vogël se Rrafshi i Kosovës. Në ndërtimin gjeologjik marrin pjesë formacionet e kenozoikut. Dominojnë sedimentet e konglomerateve, rërave dhe zhavorreve të neogjenit, me një shkallë të lartë të uniformitetit në aspektin litologjik. Temperaturat mesatare në janar lëvizin prej -0.9°C deri -1.4°C, ato të korrikut arrijnë 21°C dhe mesatarja vjetore është 10.4°C. Mungesa e reshjeve dhe thatësia (mesatarisht 500-600 mm) paraqiten si faktorë kryesorë në përcaktimin e fizionomisë së peizazhit. Kjo mungesë kompensohet nga ujërat e lumit Morava e Binçës dhe degëve të saj. Në Anamoravë jetojnë rreth 100,000 banorë. Me 232 banorë në km² është një ndër zonat me dendësi më të madhe të popullsisë. Nga resurset natyrore duhen përmendur tokat e punueshme (me ara dhe pemishte është e mbuluar 53.3% e territorit), rezervat e bentonitit në komunën e Vitisë, magnezit, kaolinit e kuarcit në Kamenicë, plumb-zinkut në lokalitetin Svirçë, antimonit në Zhujë dhe Lisockë etj. Vendbanimet janë ngritur në kontaktin ndërmjet rrafshëve aluviale dhe tarracave të lumit. Me Planin e Ahtisarit mbi decentralizimin, në rajon përveç komunave ekzistuese janë krijuar edhe tri komuna të reja me shumicë serbe: Ranillugu, Parteshi dhe Kllokoti. Qendra më e madhe industriale është Gjilani, ku ndodhet kombinati i tekstilit, fabrika e radiatorëve, e akumulatorëve dhe e duhanit. Mungesa e investimeve dhe e një procesi të mirëfilltë të privatizimit në periudhën e pasluftës, sollën si pasojë zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese dhe mbylljen e këtyre ndërmarrjeve industriale. Përveç Gjilanit, që është qendra kryesore urbano-funksionale e rajonit, Vitia dhe Kamenica janë dy qytetet e tjera të kësaj zone. (Hivzi Islami)

ANAMORAVËS (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Flitet në pjesën lindore të Kosovës, duke filluar nga fshati Binçë i Vitisë, ku buron lumi Moravë dhe vazhdon të flitet dhe përtej kufijve shtetërorë të Kosovës, deri afër Bujanocit. Dallimet dialektore midis të folmeve që shtrihen në këto dy territore, që përbëjnë një tërësi të vetme, krijojnë dy areale dialektore gjuhësore shumë të afërta. Midis këtyre dy

arealeve ka më shumë tipare të përbashkëta sesa ndryshime, prandaj njihen me emrin “E folmja e Anamoravës”. Dallimet kryesore midis kësaj të folmeje dhe varietetit të gegërishtes verilindore dalin në fushë të fonetikës dhe të morfologjisë. Diferencat gjuhësore në sintaksë dhe në leksik janë të vogla. Të dy varietetet e kësaj së folmeje njohin 6 fonema zanore, të cilat realizohen në 3 gjatësi fonetike. Zanorja ë nuk shfaqet. Gjatësia dhe hundorësia janë tipare funksionale të sistemit fonologjik të kësaj të folmeje. Ndryshe nga e folmja Moravës së Poshtme, në të folmen e Moravës së Epërme zanorja *y* del e labializuar më shumë se në të gjitha të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Ruhen grupet e vjetra vokalice *ae* dhe *oe*. Grupet *tj/dj* kanë kaluar në afrikate *ç-xh* (*atje-açe; djalë-xhal*), ndërsa bashkëtingëllorja *nj* ruhet në fillim dhe në mes të fjalës. Grupi *nd* ruhet pjesërisht, ndërkohë që në këtë të folme del edhe fenomeni i shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme: *elb-elp*; i *lagt-i lakt*. Dallimet në morfologji lidhen më së shumti me trajtat kohore të foljeve ndihmëse dhe foljeve të parregullta. Folja *kam*, në kohën e tashme, veta e parë shumë del *kena*; në të kryerën e thjeshtë del *patum*, ndërsa në të pakryerën del *kishmi*. Foljet e parregullta *bie* dhe *rri* në kohën e tashme të dëftores, në vetën e parë shumë dalin: *bijm* dhe *rrim*, në të kryerën e thjeshtë dalin *rām* dhe *nejtum* dhe në të pakryerën dalin: veta e parë njëjës *rashna* dhe *nejshna*, ndërsa në vetën e parë shumë dalin: *rashmi* dhe *nejshmi*. Në krahun jugperëndimor folja *kam* del rregullisht me këto forma: *pahām pas, pahe pās, paha pās*, ndërsa format e pluskuamperfektit: *paha pa’pas, pahim pa’pas, paham kōn, pahim kōn*. Dallimet leksikore e sintaksore janë të vogla. (Haki Hysenaj)

ANARKIA E JEGEN PASHËS (1688-1689).

Jegen Osman Pasha ishte një i krishterë i islamizuar me origjinë nga Armenia. Fillimisht njihet si udhëheqës i hajdutëve në Azi të Vogël, por më vonë arriti të bëhej Pasha i Halepit (Sirisë). Në kohën e luftërave austro-osmane 1683-1699 dhe tërheqjes së ushtrisë osmane në Beograd, Jegen Pasha u emërua bejlerbe i Rumelisë dhe komandant i ushtrisë osmane, me detyrë që ta mbronte Beogradin. Mirëpo Jegen Pasha e tradhtoi sulltanin, duke e sabotuar mbrojtjen e Beogradit, i cili u pushtua nga austriakët në shtator të vitit 1688. Jegen Pasha me ushtrinë e tij iku para bombardimit

të qytetit. Gjatë tërheqjes së Jegen Pashës dhe ushtrisë së tij nëpër Luginën e Moravës i bëri dëme të mëdha popullsisë vendëse. Rrugës drejt Nishit, Jegen Pashës iu bashkuan edhe udhëheqës të tjerë të jeniçerëve. Anarkia e Jegen Pashës përfshiu zonën nga Beogradi e deri në Pejë, Ohër e Sofje. Në vjeshtë të vitit 1688, pasi e rrënoi Sofjen, Jegen Pasha, nëpërmjet Luginës së Moravës, tërhiqet në Kosovë. Porta e Lartë mori masa të shpejta për ta likuiduar bandën e tij. Duke u gjetur në pozitë jo të favorshme, Jegen Pasha kërkoi strehim te Mahmut Pashë Begolli i Pejës, por ky, në marrëveshje me sulltanin, e likuidoi bashkë me njerëzit e tij të afërt. Koha sa zgjati seperatizmi dhe anarkia e Jegen Pashës, njihet si “Koha e hajdut Jegen Pashës”, një anarki nga e cila pësoi rëndë edhe Kosova. (Gazmend Rizaj)

ANDINI. Hy dardan. Konsiderohet si hy i vatrës shtëpiake, plleshmërisë, kujdestar i familjes dhe i bashkësisë së gjerë. Ky hy vendas, krahas Hyjneshës Dardane, llogaritet si ndër më të rëndësishmit në panteonin dardan. Është dëshmuar vetëm në dy mbishkrime të shek. I, njëri i zbuluar në Kaçanik dhe tjetri në Vushtrri. Ndeshet vetëm në arealin e ngushtë të territorit dardan dhe jo në pjesët e tjera të Perandorisë Romake, andaj është radhitur në grupin e hyjnive epihorike dardane. (Emine Kalaja-Hajdari)

ANEKDOTA POPULLORE. Tregim i shkurter humoristik a satirik i prozës popullore, që ndërlihet me ndonjë ndodhi të vërtetë ose të trilluar. Në popull njihen me emrat mesele, dokrra, mahi, rrunxosa, haka, rrotulla, fjalë me grep, shpotina, shegarime etj. Anekdota përfshin tematikë të larmishme: historike, rrethana familjare, ekonomike, politiko-shoqërore, kulturë popullore, pikëpamje etike, filozofike, logjike etj. Rëndësia e anekdotës qëndron në momentin e rrëfimit dhe të afësisë shprehëse të narratorit, të mprehtësisë dhe shkathtësisë së stilit. Dialogu anekdotik shquhet për pyetjet dhe përgjigjet e tërthorta, alegorike, kurse gjuha e qartë, e njohur për të gjithë me një komunikim telegrafik. E papritura në këtë krijim gojor është element i veçantë i artit anekdotik, që rezulton nga dialogu i zhvilluar dhe rëndom vjen me një fjali përmbyllëse. Anekdota popullore nuk duron komentime: çdo gjë në të është e kursyer dhe thuhet me shprehje lakonike,

njësoj si në veprën dramatike. Rrëfimtari anekdotik me anë të humorit a satirës synon që të vërë në spikamë dukuritë negative, me qëllim që të ballafaqohet e mira me të keqen. Në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe përgjithësisht në Kosovë janë botuar disa vëllime më anekdota, nga mbledhës të folklorit ose edhe nga autorë të veçantë. (Adem Zejnullahu)

ANGLICIZMAT. Fjalë dhe struktura të gjuhës angleze, që gjejnë përdorim në gjuhë të tjera, përfshirë gjuhën shqipe. Deri në ndryshmet e viteve ‘90, për shkak të faktorëve ideologjikë, ekonomikë e kulturorë, por edhe për kontekste të tjera globale, anglicizmat në gjuhën shqipe ishin të paktë. Me krijimin e kushteve për ekonominë e lirë të tregut, me administrimin politik e ushtarak të Kosovës nga ndërkombëtarët, si edhe me hapjen e shqiptarëve me botën, anglicizmat, sa për shkaqe objektive aq edhe për ato subjektive, vërsjuan në gjuhën shqipe. Shumë anglicizma, për shkak se shënonin koncepte të reja në fusha të ndryshme, madje edhe në ligjërimitin e rëndomtë, u futën bashkë me sendet, konceptet dhe mënyrën e re të jetesës. Edhe pse afroheshin nga kuptimi me fjalët shqipe, ato gjithsesi mbetën “më specifike” (si: disko, pab, seksi, okej, bajbaj, bodigard etj). U morën terma, sidomos për emërtimin e koncepteve të teknikave të reja, që gjetën vendin e zbrazët, si: kompjuter, maus, monitor etj. Disa anglicizma u pranuan sipas kuptimeve të mëparshme, (si: rokenroll, rep, bos, kauboj, sherif etj). Duke u nisur nga rrezja e gjerë e shtrirjes së tyre, anglicizmat mund t’i vështrojmë edhe nga pikëpamja e fushave të veprimtarisë shoqërore, si edhe nga rrafshet e gjuhës që përfshijnë. Më 1996 u botua një fjalor i anglicizmave në 16 gjuhë të ndryshme europiane, përfshirë shqipen. Pjesën e shqipes e realizoi studiuesi gjerman Rolf Këderiç. Një monografi për anglicizmat në shqipen e botoi V. Nuhiu, ndërsa studime kanë shkruar dhe J. Kabashi, I. Mehmeti etj. (Ganimet Klaiqi)

ANGRI. Lum që buron në territorin dardan dhe derdhet në Brong (Morava e sotme). Lujina e Angrit (Morava Jugore) përbënte pjesën verilindore të Dardanisë parahistorike. Sipas Herodotit, lumi kalonte në fushën e tribalëve dhe derdhej në lumin Brong. I takon pellgut të Detit të Zi, pasi përmes Moravës derdhet në Danub dhe më pas në Detin e Zi.

Angri antik njihet sot dhe si Morava e Binçës.
(Emine Kalaja-Hajdari)

ANSAMBLI I KËNGËVE E VALLEVE “KASTRIOTËT”, FERIZAJ. I themeluar më 1967, fillimisht u quajt shoqëri kulturore-artistike, deri më 1999, ndërsa në vitin 2000



ANSAMBLI I KËNGËVE DHE VALLEVE
“KASTRIOTËT”

u shndërrua në ansambël. Në nëntor të vitit 2004, me pëlqimin e Kuvendit Komunal të Ferizajt dhe të drejtorisë për kulturë, orkestra “Kastriotët” u bë gjysmëprofesionale. Historiku i punës dhe rritës së këtij Ansambli ka kaluar nëpër tri periudha: periudha I (1967-1974) karakterizohet me aktivitet dhe entuziazëm: u bë anëtarësimi i talentëve muzikorë dhe anëtarëve të orkestrës. Për ta stimuluar pjesëmarrjen e femrave soliste, më 1971 u organizua Festivali “Kosovarja këndon”. Bartës i shoqërimit të solisteve ishte Ansambli “Kastriotët”. Ishte kjo periudha më e frytshme e Ansamblit. U dhanë koncerte brenda dhe jashtë Kosovës: në Shqipëri, Belgjikë, Francë, Gjermani etj. Periudha II (1981-1990) nuk ishte e frytshme. Kërkesat për avancim politik të Kosovës bënë që politika e atëhershme jugosllave ta pamundësojë zhvillimin kulturor. Ansambli “Kastriotët” dhe veprimtarët e kulturës ishin në shënjestër të politikës diskriminuese. Trysnia e politikës serbe ishte më e ashpër sesa në vitet në vijim. Periudha III (2000-2004) u tregua si rilindje për Ansamblin. Veçohen vitet 2002-2004 të përkrahjes dhe të mirëkuptimit nga Kuvendi Komunal i Ferizajt. Në 40 vjet aktivitet, Ansambli zhvilloi veprimtari në kushte të vështira, por mbeti emblemë e Ferizajt e më gjerë, duke ruajtur vazhdimësinë e aktivitetit artistik si njëra nga orkestrinat më të mira në Kosovë. (Sami Piraj)

ANSAMBLI KOMBËTAR I KËNGËVE DHE VALLEVE “SHOTA”. U themelua më 1948, fillimisht si shoqëri kulturore-artistike, ndërsa më 1964 nga Kuvendi i Kosovës mori



ANSAMBLI I KËNGËVE DHE VALLEVE “SHOTA”

statusin e ansamblit profesional. Qëllimi i tij ishte prezantimi skenik i folklorit burimor të “kombeve dhe kombësive të Kosovës”. Në vitet ’60, Ansambli “Shota” u bë njëri nga institucionet më të rëndësishme të jetës kulturore në Kosovë, duke e përfaqësuar koloritin dhe pasurinë e folklorit të vendit në skenat vendore dhe ndërkombëtare. U paraqit në turne të ndryshme në mbarë botën dhe e bëri të njohur gjithandej traditën kulturore të vendit, kryesisht atë shqiptare. Në kuadër të këtij Ansambli kanë dhënë kontribut emra të njohur të kulturës, si koreografë, valltarë, këngëtarë, instrumentistë, kompozitorë, etnomuzikologë etj. Me programin e tij, Ansambli u prezantua në Çekosllovakia (1965), Zvicër, Francë, Belgjikë (1966), Holandë, Luksemburg, Turqi (1967), Gjermani Lindore, BRSS (1970, 1974), Shqipëri (1973), Gjermani, Itali (1980), SHBA (1987). “Shota” veprimi edhe në vitet ’90, në kuadër të institucioneve të Kosovës, duke u paraqitur në Turqi, Zvicër, Francë, Mal të Zi, Kosovë, Preshevë. Dëshmi e këtyre sukseseve janë çmimet prestigjioze në shumë festivale, nga të cilët veçohen: vendi i katërt në Tunizi (1969), vendi i dytë në Dizhon të Francës (1986), vendi i tretë në Seul të Koresë Jugore, vendi i dytë në Buyukçekmeçe të Turqisë, vendi i parë në Bursa të Turqisë, pastaj në Sicili vendi I, në Bullgari po ashtu vendi I (2014). Janë realizuar rreth 7,000 prezantime skenike të Ansamblit “Shota”. Pas luftës së vitit 1999 Ansambli u riorganizua si institucion, ribëri programin dhe mori atributin e Ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve. (Xhevdet Gashi)

ANSAMBLI KORAL “COLLEGIUM CANTORUM” (1969-2004). Meritat për krijimin e tij i kishte kompozitori dhe dirigjenti Mark Kaçinari, i cili me ndihmën dhe përkrahjen e



kolegëve, e themeloi më 1969. Sukseset e korit, brenda dhe jashtë vendit, ishin të dukshme. Që më 1972 mori pjesë në Festivalin Ndërkombëtar në Langolen të Britanisë së Madhe, ku zuri vendin e tretë me tri këngë korale, në mesin e të cilave dhe “Vjeshta” e Rexho Mulliqit. Më 1978 “Collegium Cantorum”, në formë koncertale, interpretoi operën e parë në Kosovë “Goca e Kaçanikut” të kompozitorit R. Dhomi. Një tjetër sukses i tij qe realizimi i veprës “Requiem” të Mozart-it (28. prill 1979) në bashkëpunim me Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës, dirigjuar nga Mark Kaçinari. Kori interpretoi vepra kompozitorësh shqiptarë e botërorë: Bach, Haydn, Mozart, Monteverdi, Smetana, Verdi, Zadeja, Gjini, Antoni, Mulliqi, Kaçinari, Beqiri etj. Nga viti 1985 Korin e udhëhoqi dirigjenti dhe kompozitori Gjergj Kaçinari deri më 2004, kur u shua. Sukseset e korit nuk munguan as në vitet e pasluftës, siç ishte koncerti në vitin 2000. (Kristina Palokaj-Përkola)

ANTOLAK (Antoljak) Stjepan (1909-1997). Historian kroat, profesor universiteti, akademik. U diplomua për histori dhe u doktorua po në këtë fushë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit (1935), ku punoi deri në vitin 1952. Ishte drejtor në Arkivin Shtetëror të Zarës (1946-1952) dhe bashkëpunëtor shkencor në Arkivin Shtetëror të Rijekës (1953-1956). Ligjëroi historinë e mesjetës në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit (1956-1969) dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1963-1969). Ishte



STJEPAN ANTOLAK

njëri nga themeluesit e katedrës së historisë të Universitetit të Prishtinës dhe ligjërues i disa lëndëve të historisë. Udhëhoqi departamentin e historisë së antikitetit dhe të mesjetës së Maqedonisë në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup (1967-1971). Ishte njohës i mirë i historisë së popullit kroat, popullit maqedonas dhe popullit shqiptar. Përgatiti për botim dy përmbledhje dokumentesh, të cilat i botoi në maqedonisht, në serbisht dhe në shqip “Shkenecat ndihmëse të historisë” (1966-1972), si dhe disa vepra me interes shkencor për historinë e Maqedonisë dhe të Kroacisë. Botoi edhe artikuj me interes në revistat shkencore në Shkup, Prishtinë, Zagreb e në Zarë, që kishin të bënin me periudhën e mesjetës. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Vdiq në Zagreb. (Ramiz Abdyli)

ANTONI Lorenc (1909-1991). Kompozitor, etnomuzikolog, pedagog dhe drejtues kori. Lindi në Shkup, ku i mori njohuritë themelore muzikore dhe i vazhdoi më tej privatisht në Beograd. Më 1941 erdhi në Kosovë, duke u vendosur në Prizren, ku drejtoi korin e Shoqërisë kulturore-artistike “Agimi”, me të cilin arriti suksese edhe jashtë Kosovës. Në vitet 1948-1956 ishte nismëtar dhe pastaj arsimtar e drejtor i



LORENC ANTONI

Shkollës së Ulët dhe të Mesme të Muzikës “Josip Sllavenski” në Prizren. Të kësaj periudhe janë punimet e tij të botuara etnomuzikologjike, si: “Format muzikore dhe veglat popullore të shqiptarët” (1950) dhe “Ritmi i këngëve popullore shqiptare” (1952), pastaj orkestralet: “Në Prizrenin e bukur” (1952) dhe cikli i përpunimeve korale të botuara me titull “Kore shqiptare” (1957). Më 1956 deri në pension ishte redaktor i muzikës popullore në Radio-Prishtinë, më pas i produksionit muzikor të Radiotelevizionit të Prishtinës, ku udhëhoqi grupe këngëtarësh. L. Antoni më tej, me aktivitetin e tij prej melografi dhe analisti studimor, mblo dhi dhe mbarështroi afër 800 këngë dhe melodi

shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës. Rezultat i kësaj pune krijuese etnomuzikologjike janë shtatë blej të mbledhur dhe më pas të botuar njëri pas tjetrit me titull të përbashkët “Folklori muzikor shqiptar” (1956-1976). Aktivitetin krijues e vazhdoi edhe si autor përpunimesh dhe kompozitor veprash korale, si: “Kore shqiptare”, “Jehonat e zemrës” (1960), pastaj suitat “Opojanja” (1962) dhe “Në shendin ulqinak”, kënga korale “Skënderbeu ngadhënjimtar” kompozuar në 500-vjetorin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (1968), “Një gafore defatore” për kor pionierësh (1974), vepra për orkestër mandolinatash me ose pa solist (“Dhëndrri fëmi”, “Moj e mira vashë e bardhë”), disa “Rapsodi shqiptare” për orkestër tamburinash (1960), si dhe disa të tjera orkestrale: “Në Prizrenin e vjetër” (1959), “Në Prizrenin e bukur”, “Tri valle shqiptare” (1962-65), “Malësorja” (1966) etj. (Zeqirja Ballata)

ANTROPOLOGJIA. Shkencë që studion të kaluarën dhe të tashmen e njeriut me qasje krahasuese, duke u mbështetur në shkencat shoqërore dhe natyrore. Ndahet në katër nënfusha: sociokulturë, linguistikë, biologji/fizikë dhe arkeologji. Antropologjia veçohet nga shkencat e tjera për thellimet e saj në krahasimet ndërkulturore, ekzaminimet afatgjate kontekstuale dhe të vërejturit me pjesëmarrje, si veçori të hulumtimit etnografik dhe punës në terren. Antropologjia ka trajektore të ndryshme zhvillimore, varësisht nga kontekstet historike dhe politike dhe formësimi të institucioneve të dijës dhe të shkencës. Hulumtimi dhe mendimi antropologjik është ngushtë i lidhur me zhvillimet kryesore politike, teknologjike dhe shkencore në Europë gjatë shekullit XIX dhe me shpërndarjen e tyre globale, përfshirë këtu edhe revolucionin industrial, darvinizmin dhe kolonializmin. Në Kosovë, ngjashëm me vendet e tjera ish-socialiste dhe me ndikim të shkollës gjermane herderiane dhe të materializmit dialektik, dominonte studimi folkloristik dhe etnologjik, e shpesh edhe esencializmi kulturor dhe determinizmi biologjik. Kjo nënkuptonte qasje përshkruese, sinkronike dhe përqendrim mbi eksplorimin kulturor të një etnie. Kjo qasje pësoi ndryshime qysh nga fundi i viteve '90, duke iu përafuar qasjeve anglo-amerikane, por edhe duke përfshirë teoritë postkoloniale, feministe dhe kritike. (Nita Luci)

APELI 215 (1989). Peticion i nënshkruar nga 215 intelektualë shqiptarë të Kosovës kundër ndryshimeve kushtetuese të vitit 1989. “Apeli 215”, siç u quajt më vonë, kishte për qëllim mbrojtjen e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974, si kundërvënie ndaj politikës së Serbisë, e cila me këto ndryshime kushtetuese synonte suprimimin e autonomisë së Kosovës. Iniciator dhe përpilues të “Apelet 215” ishin akademik Gazmend Zajmi dhe historiani Zekeria Cana, të cilëve iu bashkëngjiten shumë akademikë, punëtorë shkencorë e kulturorë, shkrimtarë, gazetarë, mjekë etj. Në tekstin e “Apelet”, ndër të tjera, i bëhej kritikë qasjes nacionaliste mesjetare serbe dhe politikës hegjemoniste ndaj Kosovës, madhërohej Lufta Nacionalçlirimtare dhe revolucioni socialist, si dhe proklamohesh modeli i një Kosove si bashkësi e të gjitha nacionaliteteve, në frymën e vëllazërim-bashkimit jugosllav. Në tekst thuhej se apeli ishte legjitim dhe kushtues, “i frymëzuar nga vlerat më të çmueshme të Revolucionit Socialist” dhe kishte për qëllim “afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ-së”. “Apeli” theksonte se populli shqiptar në Jugosllavi nuk ishte kundër ndryshimeve kushtetuese në tërësi, por kërkonte mosprekjen e parimeve themelore të Kushtetutës së vitit 1974 dhe të pozitës kushtetuese të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Pas publikimit të “Apelet 215” në Kosovë u zhvillua një fushatë e egër e diferencimit ideopolitik, duke i stigmatizuar organizatorët dhe nënshkruesit e këtij peticioni. (Liman Rushiti)

APLIKA E MERKURIT. Pjesë e objektit prej bronzi i periudhës romake. U modelua në trajtë busti (15 cm) dhe u gjet rastësisht në Studençan të Suharekës (2001). Objekti me patinë pjesërisht të gjelbër është ruajtur mirë, pos krahut të thyer dhe flatrës, si dhe çarjes rreth qafës në anën e majtë. Është modeluar me detaje të trajtuara mirë të perëndisë Merkur, i cili është paraqitur lakuriq, me tipare femijërore të fytyrës. Në kokë ka flatra të vogla, të kthyer lehtë në të djathtë dhe fytyra ovale ka faqe të plota dhe ballë të lartë. Sytë janë të mëdhenj, me kapakë dhe bebëza të thelluara dhe mjaft të theksuara. Hunda është e gjerë, buzët janë të trasha e të hapura lehtë dhe mjekra ka një gropëz në mes. Flokët e stilizuara

janë kaçurrel, të ndara në mes dhe bien në të dy anët mbi veshë, deri në zverk. Gjoksi është i fryrë lehtë dhe në fund të bustit gjendet një hallkë gjysmërrethore dekorative. Hallka tjetër, e vendosur në zverk, kishte funksion praktik, meqë në të kapej grremçi, i cili nuk është ruajtur. Aplika paraqet unikat në trevën dardane, ndërsa në provincat e tjera romake kishte funksion praktik të peshës në kandar, siç mund të vihet në përfundim nga rreth 30 bust-aplika të tilla me figurë fëmije apo djaloshi. Në bazë të hallkës në fund të bustit, duket se aplika e Studençanit kishte funksion dekorativ-simbolik në ndonjë qerre transportuese ose në shtëpi të ndonjë tregtari. Këto janë në pajtim me natyrën e Mërkurit, si perëndi i tregtisë, i cili konsiderohet dhe si zbulues i masave për gjatësi dhe peshë. Pa marrë parasysh funksionin, ky bust-aplikë paraqet punë të mirë të një punëtorie vendëse, rreth fillimit të shek. III. (Exhlale Dobruna-Salihu)

APOLLONI Ag (1982-). Shkrimtar, studiues dhe mësimdhënës i letërsisë në Universitetin e Prishtinës. Lindi në Kaçanik, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet



AG APOLLONI

për letërsi shqipe dhe dramaturgi në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2009 mori gradën master, ndërsa në vitin 2012 mori titullin doktor i letërsisë. Shkruan poezi, prozë, dramë dhe kritikë letrare. Është autor i librit me poezi “Zomb” (2009), i librave me drama “Katër drama” (2010) dhe “Historia e një koleksionisti të syve dhe drama të tjera” (2016), i monografive “Parabola postmoderne” (2010) dhe “Paradigma e Proteut” (2012), i romanit “Ulurima e ujkut”, (2013) dhe i novelës “Zazen” (2014). Krijimtaria e tij letrare është shpërblyer me disa çmime kombëtare. Ka qenë kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re” (2010-2012) dhe themelues e kryeredaktor i revistës për kulturë “Symbol”. (Agron Gashi)

APOLLONI Ben (1980-). Regjisor, skenarist. Lindi në Stagovë të Kaçanikut. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Kaçanik. Kreu studimet për regji teatri dhe regji filmi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Bëri regjinë

e disa shfaqjeve teatrore: “Miss Julia” në Teatrin Shqiptar të Shkupit, “Orkestra e Titanikut” në Teatrin e Gjilanit, “Mat” në Teatrin “Dodona”, “Na bijtë e shekullit të ri” në Teatrin e Mitrovicës, “Nata e Helverit” në Teatrin e Pejës, “Muaji i mjaltit” në Teatrin e Prizrenit etj. Ka shkruar skenarët për filma të shkurtër: “Tuneli”, “Republika”, “Turpi”, “Vajza”, “Identiteti”, “Kati i pestë”, “Viza” etj. U nderua me çmime të ndryshme: me çmimin regjisor i më i mirë” në Festivalin e Teatrove në Ferizaj (2009), çmimin për skenar më të mirë për filmin e shkurtër “Republika” (2008), me çmimin filmi më i mirë për filmin e shkurtër “Kati V” në Festivalin 9/11 (2013), si dhe çmimin për skenarin më të mirë në Festivalin “Apolonia International Film Festival” në Fier. (Erson Zymberi)

APOLLONI I ULPIANËS. Shtatore miniaturë e periudhës romake, e punuar në bronz. Është gjetje e rastit nga Ulpiana (1956). Gjatësia e saj është 11.5 cm dhe i mungon dora e djathtë,



APOLLONI I ULPIANËS

bashkë me atributet, ndërsa sipërfaqja i është dëmtuar nga korozioni. Apoloni është paraqitur i ri, lakuriq dhe me këmbë të kryqëzuara e dorë të majtë të lakuar në bërryl. Koka, e kthyer në të djathtë dhe e modeluar me vija të buta, është në harmoni me pozicionin e trupit. Fytyra është modeluar me vija të njëjta, të buta dhe me detaje precize. Po aq mirë janë modeluar flokët me krela, të cilët në maje lidhen në një

karakteristike të Apolonit (“krobylos”), ndërsa pjesa tjetër e tyre e rrethon fytyrën me dy spërdredhje mbi supë. Figurina, me tiparet themelore të skulpturës së Praksitelit, duket e afërt me realizimin “Apolon Kitharoidosit” të skulptorit Timarhides (shek. II p.e.r.), ku perëndia është paraqitur i mbështetur me dorën e majtë në lyrë. Nga statuetat e Apolonit në bronz, ngjashmëri ndeshen tek ajo nga Sarmizegetusa në Daki dhe Martinci në Panoni (Kroaci). Figurina është elaborim i origjinalit helenistik dhe një vepër e cilësisë së lartë artistike nga periudha e hershme romake.

Është importuar nga ndonjë qendër e njohur artistike, e cila në Ulpianë u shfrytëzua në funksion të altarit shtëpiak ose të zbukurimit. Është realizim i vetëm skulpturor i Apolonit në Kosovë dhe i dyti në Dardani, i gjetur në Shkup. (Exhlale Dobruna-Salihu)

ARABIZMAT. Fjalë, struktura gjuhësore, kompozita a thënie me prejardhje arabe, që janë përdorur apo përdoren ende në ndonjë gjuhë botërore, përfshirë shqipen. Në gjuhën shqipe numri më i madh i arabizmave ka depërtuar nëpërmjet turqishtes. Një numër arabizmash në shqipen ka hyrë përmes gjuhëve europiane (zero, alkool). Këto fjalë paraqiten me të njëjtin kuptim dhe formë që kanë edhe në original, ose me ndryshime morfologjike dhe semantike. Arabizmat sot më së shumti përdoren në të folme, por një pjesë e mirë e tyre tashmë janë ngulitur në gjuhën shqipe dhe si të tilla janë përfshirë në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”. Shumica e arabizmave në gjuhën shqipe bëjnë pjesë në grupin e emrave dhe të mbiemrave, por në mesin e tyre mund të gjendet edhe ndonjë folje (*inatos* nga *inat*, *hasmëroj* nga *hasëm*, *rehatoj* nga *rehat* etj.). Arabizmat i kanë trajtuar në punimet e tyre: T. Dizdari, H. Kaleshi, F. Mehdiu, M. Polisi, A. Ismaili, J. Hundozi etj. (Jahja Hundozi)

ARAPI Sylejman (1917-1991). Mjek, oftalmolog. Lindi në Prizren, arsimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në qytetin e lindjes, ndërsa studimet i filloi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, i vazhdoi në Itali gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe sërish u kthye në Zagreb, ku u diplomua në vitin 1945. Tri vjet punoi në Qendrën klinike “Rebro” të Zagrebit, më pas u kthye në Prizren në vitin 1949. Përfundoi specializimin në lëmin e oftalmologjisë në Beograd në vitin 1955, më pas punoi në Prishtinë dhe më 1959 u kthye sërish në Prizren, ku themeloi dhe drejtoi repartin e oftalmologjisë në Qendrën Mjekësore të Prizrenit. Ishte mjeku i katërt shqiptar në Kosovë dhe oftalmologu i dytë në shkallë vendi. Ka merita të mëdha në zhvillimin e oftalmologjisë në rajonin e Prizrenit dhe në Kosovë. Botoi disa punime profesionale. (Elhami Goranci)

ARBANASI Musa (shek. XIV). Janë dy personazhe historike me të njëjtin emër/atribut, pjesëmarrës në Betejën e Kosovës (1389). Se

kush ishte në të vërtetë personi historik Musa Arbanasi është vështirë të nxirret një përfundim, sepse për këtë figurë më pak mësohet nga historiografia e më shumë nga folklori serb, bullgar dhe maqedon. Nga burimet historike del se Musa Arbanasi është në të vërtetë Theodor Muzaka II, i cili kishte rënë në Betejën e Kosovës të vitit 1389. Ky ishte bashkëkohës dhe kundërshtar i renegatit serb Marko Kraljeviq të osmanëve. Në folklorin dhe në historiografinë serbe, përveç si Musa Arbanas, e quajnë edhe Musa Kesexhia, duke e mbajtur për vëlla të Theodor Muzakës II. Porse ka edhe një të dhënë, sipas së cilës Musa Arbanasi/Musa Kesexhia i folklorit serb ishte në të vërtetë një feudal vendës i krahinës së sotme të Llapit (si edhe Milosh Kopiliqi i Drenicës), i lidhur edhe ky në vijën e krushqisë me derën feudale serbe të princit Lazar, që do të ketë marrë pjesë në Betejën e Kosovës. Këtë e quajnë edhe me atributin “çelnik” (Musa), titull që në greqisht, si dhe në serbishten mesjetare e kishte kuptimin “strateg, ushtarak”. Prejardhja vendore arbërore e këtij prijësi lokal shihet edhe nga fakti se ai, sipas epikës sllave, ua kishte kthyer shpinën hasianëve dhe përkrahte pushtuesin e ri, prandaj Marko Kraleviqi e vret dhe kokën e këtij “renegati” ia dhuron sulltanit. Musa Arbanasi nuk del të ketë qenë i vetmi feudal vendës i përfshirë në Betejën e Kosovës, sepse në vetë burimet kishtarë rasiene të kohës para Betejës së Kosovës kishte disa feudale arbëror, emrat e të cilëve janë ruajtur në mikrotoponime, si Muzakajt, Balshajt në Fushën e Kosovës dhe disa të tjerë në Rrafshin e Dukagjinit. (Skënder Gashi)

ARBËRIA. Emër mesjetar i Shqipërisë. Mendohet se emërtimi *Albanon* (Ἀλβανών), që doli nga emri i fisit ilir Albanoi (Ἀλβανοί), i përmendur nga gjeografi aleksandrin Ptolemeu (shek. II), ka vazhduar të ekzistojë si emër vendi dhe si emër etnik gjatë gjithë mesjetës. Etnonimet mesjetare: *arbër*, *arban* ose *arbrësh* pas pushtimit osman janë përdorur për shqiptarët e diasporës më Itali, Dalmaci dhe Greqi. Deri vonë ishte menduar se prej Ptolemeut deri në shek. XI, kur “rishfaqet” emërvendi *Arbanon*, *Albanon*, ka pasur një heshtje të burimeve historike. Sot ka prova sipas anave dhe kronikave raguzane (*Arbania*, *Albania*) dhe bizantine (Ἀλβανία), që dëshmojnë se emërvendi dhe etnonimi janë përdorur pa

ndërprerje nga shek. II deri në shek. XI. Tek autorët e vjetër shqiptarë kemi: Arbani (Buzuku), Arbënë (Budi). Në sllavishten e jugut është huazuar forma metatetike *raban*, që ka ndodhur nga fillimi i shek. IX.

Pjesa më e madhe e historiografisë ballkanike arealin gjeografik dhe politik të Arbërisë mesjetare, në mungesë të burimeve të kohës, e ka përkufizuar në një zonë të vogël malore ndërmjet lumenjve Mat dhe Drin, ose në katërkëndshin hipotetik Tivar-Prizren dhe Vlorë-Ohër. Nga kapërcyelli i shek. XI deri në fillimet e shek. XIII ishte themeluar Principata e Arbërit me seli në Krujë. Nga viti 1272, mbreti Karli I Anzhuin kishte themeluar *Regnum Albaniae*, ndërsa mbreti Milutin dhe Dushani e quanin veten edhe mbretër të Arbërit. Pas rënies së shtetit të Dushanit, Arbëria drejtohej nga familjet bujare arbërore: Arianiti, Balshaj, Dukagjini, Kastrioti, Muzakaj, Shpataj, Topia, Zenebishi etj. Me rënien e Durrësit (1501), të Tivarit dhe të Ulqinit (1571), Arbëria, pasi ishte pushtuar përfundimisht nga osmanët, është shoqëruar edhe me një sërë ndryshimesh si në strukturën e emrit të vendit, ashtu dhe të etnonimit.

Duke u ngjitur në shekujt e mesjetës, emërtimet gjeografike e politike Arbanon, Arbëri ose Epir e Dardani, përfshinin trevat e sotme të Kosovës, pjesë të Serbisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë e të Greqisë. Të tilla njoftime datojnë që nga mesjeta e hershme, si bie fjala, *Lapiam* (Lab), i referohet *Lab-it* (Llapit). Kosovën si pjesë të Arbërisë e shohim të kronisiti francez i shek. XIV, Filip de Mezière, i cili provonte të dëshmonte se Beteja e Kosovës (1389) ishte zhvilluar në Arbëri. Mendime të ngjashme ndeshim të Brokieri, sipas të cilit pjesa e madhe e Kosovës së sotme ishte përfshirë në kuadër të Arbërisë. Njoftime të këtilla ndeshim edhe në dokumentacionin austriak, osman e italian të shek. XV-XVIII: “perandori austriak Leopoldi theksonte se ushtritë e tij luftonin në Arbëri (kur hynë në Kosovë)”, “Prishtina në Arbëri”, “Peja qytet në Arbëri”, “Prizreni, kryeqytet i Arbërisë”. Në mënyrë të barasvlershme me konceptin Kosova pjesë e Arbërisë, dokumentacioni i kohës dëshmon edhe për Kosovën në kuadër të konceptit Epir. Të tilla janë njoftimet: “Hasi, jo fort larg Prizrenit, provincë në Epir”, “Prishtina në Epir”, “Peja në Epir”, “Prizreni në Epir” etj. Përveç apelativave të përmendur, Kosovën e sotme e ndeshim edhe në pjesë të Dardanisë dhe të Mezisë së Epërme. (Jahja Drançolli)

ARBËRISHTJA E GREQISË. Varietet i shqipes (toskërishte) që flitet nga arvanitët e Greqisë, por jo nga çamët. Arvanitët (ose arbëreshë të Greqisë) janë vendosur në Greqi



HARTA E GJUHËVE MINORITARE NË GREQI

qysh nga shekulli XIV dhe popullojnë vise të Atikës, të Peleponezit, disa ujdhesa (Specia, Hidra, Poros) dhe të Beotisë. Kanë luajtur rol të veçantë për krijimin e shtetit modern grek. Hani i ka dhënë të parat shënime për të folmet e arvanitëve (1854). Për këtë të folme kanë shkruar Rainhold, Furiki, Zase, Hemp, Johalas etj. Kjo idiomë dialektore karakterizohet me tiparet e fazave më të vjetra të shqipes, sidomos të toskërishtes jugore. Ruan grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl, lg* (*klaj, gluri*), si edhe grupet *mb, nd, ng*. Dallohet për ruajtjen e *-l-së* ndërzanore (*golë, milë, fëmilë*), kalimin e *e-së* në *ë* para sonanteve hundore etj. Ndërsa si tipar morfologjik i arvanitishtes është përdorimi i së ardhmes me *do+lidhore* (*do t'mbetem, do t'i presmi* etj.), përdorimi i aoristit sigmatik (*u leshë-u leva, u bësha-u bëra* etj.). Nga sfera e morfosintaksës është karakteristik ndërtimi i tipit foljor me vlera të infinitivit të toskërishtes së sotme për *të+pjesore* (*M'thojnë për t'vej nd Athinë e nuk ika*). Në fushën e leksikut arvanitishtja dallohet me numër të madh të huazimeve nga greqishtja. Nuk gëzon asfarë statusi publik. Bën pjesë në mesin e gjuhëve të rrezikuara, meqë pjesa më e madhe e të rinjve arvanitë nuk e flet më. (Imri Badallaj)

ARBËRIT. Emri mesjetar i kombit të të gjithë shqiptarëve (shek. XI-XVII). Emri më i vjetër i njohur i *arbërve*, që pas shek. XVII do të quhen *shqiptarë*, është i pandashëm nga emri Ἀλβανοί (Albanoi) i njërës nga bashkësitë fisnore të ilirëve të jugut. Kryeqendër e fisit Albanoi ishte qyteti Albanopolis, që për herë të parë përmendet nga gjeografi Aleksandrin Ptolemaeus (Ptolemeu) në shek. II të e. s. Ky qytet është identifikuar me rrënojat në katundin e sotëm Zgërdhesh, 3 km larg Fushë-Krujës. Pas heshtjes prej disa shekujsh Albanoi dhe hapësira e banuar nga ata përmendet rishtazi në shek. XI, sipas burimeve tregimtare bizantine. Sipas një mendimi, emri Albanoi është i pandashëm nga rrënja paraindoeuropiane *alb-/alp* - "lartësi; bjeshkë". Tezën për prejardhjen paraindoeuropiane të emrit *arbën/arbër* të shqiptarëve e ka kundërshtuar E. Çabej. Sipas tij tek *arbën/arbër* kemi të bëjmë me një emër vendor të sajuar nga goja e shqipfolësve. Fjala bazë e këtij emri do të ketë qenë **arb-an* e dalë nga një trajtë më e vjetër **arv-* e gurrave indoeuropiane e kohës së antikës e të mesjetës së hershme dhe e afrueshme p.sh. me lat. *arvum* (arë, tokë e punuar). Sipas tij, emri *arbën* nuk mund të jetë latino-roman. Varianti *arbën/arbër* i emrit etnik të shqiptarëve ishte në përdorim edhe për popullatën shqiptare në hapësirat e sotme të Kosovës, të Maqedonisë Perëndimore, të Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi. Në burime kishtare serbe, raguzane dhe osmane të shek. XIII-XV, ky emër është dëshmuar në variantet *arbanas*, *arbanash* dhe *arbanesh/arbënesh*. (Skënder Gashi)

ARBITRAZHI. Procedurë apo metodë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike ndërmjet dy apo më shumë palëve, me çrast palët emërojnë një apo më shumë persona neutralë (arbitra) për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjen juridike përkatëse. Palët e përfshira në një mosmarrëveshje mund të përzgjedhin arbitrat në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse pajtohen për këtë apo në mënyrë indirekte, duke u pajtuar që arbitrat të përzgjidhen nga një organizatë e arbitrazhit. Në këtë procedurë vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet procedurës së apelimit. Pra, palët kanë të drejtë të kërkojnë anulimin e vendimit të arbitrazhit në rast të shkeljeve të rënda, si në vijim: nëse njëra palë në marrëveshjen e

arbitrazhit nuk ka pasur zotësinë e veprimit; në rast se marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas të drejtës së zbatueshme; nëse pala ankuese nuk ka qenë e njoftuar për emërimin e ndonjë arbitri apo mbi procedurën e arbitrazhit apo nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e vet para Tribunalit të Arbitrazhit; nëse vendimi i arbitrazhit shtrihet në një çështje për të cilën nuk është kompetent Tribunali i Arbitrazhit; në rast se përbërja e Tribunalit të Arbitrazhit ose procedurat e zhvilluara nuk kanë qenë në pajtim me ligjin apo marrëveshjen e arbitrazhit; nëse arbitrazhi është i ndaluar me ligj për çështjen e vendosur dhe në rast se ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit do të cenonte apo do të ishte në kundërshtim me rendin publik. Në Kosovë arbitrazhi ofrohet nëpërmjet Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. (Dastid Pallaska)

ARBESHËVE TË ZARËS (E FOLMJA E). Idiomë dialektore e shqipes që flitet nga një komunitet në Zarë të Kroacisë dhe është në listën e gjuhëve të rrezikuara për zhdukje



FSHATI ARBANAS, ZARË

sipas kritereve të UNESCO-s. Është variant i gegërishtes veriperëndimore me elemente të kroatishës dalmatine dhe të italishtes. Arbeshët janë shpërngulur nga katundet e Krajës (Brisk, Shestan, Ljare, në Malin e Zi të sotëm) në tri faza (1726, 1727, 1733) në disa pika në rrethinë të Zarës, duke u përqendruar kryesisht në një lagje periferike të quajtur Borgo Erico e më pas Arbanas. Për këtë idiomë kanë shkruar autorë si K.

Tagliavini, I. Ajeti, K. Kërstiq dhe, së fundi, një monografi e ka realizuar M. Barançiq. Kjo idiomë karakterizohet nga veçori fonetike të gegërishtes veriperëndimore, si tendenca e buzorëzimit të *a*-së hundore, ruajtja e grupeve *ua* dhe *uo*, përdorimi i *ë*-së në vend të *i*-së në pozicion paratheksor, mungesa e kundërvënies *r-rr*, mungesa e bashkëtingëllores *dh* (përdoret *ll*) dhe ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng* si dhe mungesa e *y*-së që zëvendësohet me *u* ose në raste të rralla me *ë*. Në morfologji kjo e folme ka format analogjike të shumës të disa emrave: *kalat* (*kuajt*), *dorat* (*duart*), *derat* (*dyert*) etj. Gjinia asnjëse po rrudhet si në mbarë shqipen, por vazhdon të përdoret, ndërsa në sistemin foljor paraqiten në këtë të folme dysi formash: *vir* dhe *vjer*, *piç* dhe *pjek*, *mbet* dhe *jet* etj. Disa forma foljore të kohës së tashme shpeshherë kanë kuptimin e së ardhmes: *Du dit mbesim ktu* (*Dy ditë do të mbesim këtu*). E kryera e thjeshtë del me dy forma: me *-v-* dhe me *-jt-*: *pova*, *shkova*; *pojta*, *shkojta* etj. Në morfosintaksë dendur përdoret prapavendosja e trajtave të shkurtra, krahas atyre të paravendosura: *!Juve ju ka thon// At e kom po!* etj. Leksiku ka shumë huazime nga kroatishtja dhe italishtja. Sot janë disa dhjetëra folës të kësaj idiomë, kryesisht të moshave të vjetra. (Imri Badallaj)

ARËNLIU Aliriza (1975-). Psikolog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Prizren, arsimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në qytetin e lindjes, kurse studimet në Universitetin e Bogaziçit në Stamboll, Turqi. Doktoroi më 2009, në Universitetin “Ludwig Maximilians” në Munih të Gjermanisë. Është njëri ndër themeluesit e departamentit të psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëron që nga viti 2001. Në revista të ndryshme profesionale botoi një sërë artikujsh studimorë nga kjo disiplinë, për tema që lidhen me shëndetin mental, psikologjinë e edukimit, psikologjinë sociale, psikologjinë e këshillimit etj. Gjithashtu është autor i një doracakut për parandalimin e dhunës. Punoi në shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe kontribuoi në themelimin e shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet në Kosovë. (Dashmir Bërçullli)

ARGOTË. Idioma gjuhësore artificiale, të krijuara nga grupe të ndryshme shoqërore, për

nevoja të komunikimit mes vete. Shërbejnë si mjete identifikimi për grupin dhe si gjuhë sekrete për të mos u kuptuar nga të tjerët. Argo mund të quhet sociolekti i çdo grupi, anëtarët e të cilit përpiqen ta fshehin përmbajtjen e mesazheve të tyre nga grupet e tjera ose nga pjesa tjetër e shoqërisë. Argo të vërteta janë gjuhët e fshehta të të rinjve, të studentëve, të zejtarëve, të muratorëve, të keqbërësve etj. Argotë paraqesin më tepër një shmangie nga gjuha sesa një gjuhë më vete. Aty, me anë të metaforave e të tropeve, fjalët e zakonshme të gjuhës marrin domethënie të ndryshme, si p.sh.: *grykëhollë* (pushkë, armë), *bar* (lloj droge), *qorri* (ai që mban gjyzlykë), *të zitë* (policët) etj. Një argo e tillë në Kosovë është e folmja e të rinjve të Prishtinës, në të cilën bëhet permutacioni i tingujve brenda fjalës, por mbahet gramatika e idiolektit të folësit. Fjalësi (disa qindra fjalë) i kësaj argoje përfshin fushat e nëntokës (cilimi-polici, tokaja-ika, ia shmoja (jomsha-nga mëshoj) -ia vodha, pexhi-xhepi etj.) dhe të jetës sociale-dashurore (e thupa-e putha, mamajana, ragicat-cigaret). Kjo argo ka pësuar ndryshime në periudha, sipas ndryshimeve të brezave dhe të grupeve shoqërore. Sot përdoret një pjesë e këtij fjalësi, si dhe disa krijime të reja: *lladikë-budalla*, *ishmi-shihemi*, *nys-syn* (i/e dashur) etj. Para kësaj e më vonë një rol të tillë e ka pasur turqishtja e më pas edhe serbishtja. Si argo mund të merren edhe gjuha e romëve ose sllavishtja e mjeshtërvë *gollobordas* të ndërtimit, kur përdoren në mjedise të përziera, për të mos u marrë vesh nga të tjerët. Argotë janë gjuhë në proces, burojnë nga subkulturat brenda shoqërisë dhe në kontakt me kulturën gradualisht humbin statusin sekret dhe kështu edhe funksionin e tyre. Termi argo te disa autorë del sinonimik me termin zhargon. (Shkumbin Munishi)

ARGJENDARIA. Lloji i zejtarisë artistike që merret me prodhimin e stolive dhe zbukurimin e armëve, të realizuara nga mjeshtrit argjendarë. Pjesët kryesore të prodhimeve janë punuar prej ari dhe argjendi, i larë me ar, ndërsa të tjerat prej mesingu dhe bakri. Argjendarët punonin me teknikat e filigranit në Prizren, të savatit në Gjakovë dhe të granulimit në Pejë. Dominoi teknika e filigranit, e cila përdor fijen shumë të hollë dhe të dredhur të argjendit, për të krijuar vepra artistike. Argjendarët i stolisnin pushkët, koburet, jataganët e thikat me fletëza mesingu



PUNIME ARTIZANALE TË ARGJENDARISË

ose argjendi. Prodhonin edhe stoli për banorët e qyteteve dhe të fshatrave të Kosovës, për burra, për gra dhe fëmijë, stoli me karakter kulti, enë dhe objekte të ndryshme. Stolitë e burrave, përveç armëve të stolisura, ishin edhe qostekët për orë xhepi, sumbullat për këmisha, stoli kraharori, çibukë, kuti duhani, taketuke dhe çakmakë argjendi. Stolitë e grave përbëheshin kryesisht nga unazat, vathët, byzlykët, qaforet, zinxhirë kraharori, medaljone, pafta brezi dhe stoli të kokës, ndërkaq stolitë e fëmijëve nga unazat, byzlykët, zinxhirët dhe çantat. Stoli me karakter kulti tradicionalisht kanë qenë zinxhirët me varëse në formë kryqi dhe varëset në formë të hajmalisë. Janë punuar dhe janë stolisur dhe enë e objekte të tjera shtëpiake, si: gota, lugë, pirunë, thika, mbajtës filxhanësh, tabaka, kuti të stolive dhe të kozmetikës, korniza të fotografive, vazo dhe objekte në formë të anijes, të xhamisë, të urës etj. Me anë të stolive pasqyrohej gjendja ekonomike dhe prestigji shoqëror i bartësit. Stolitë e argjendarëve kosovarë sot vlerësohen si vepra të mëdha artizanale. Argjendarët punojnë sot kryesisht modele të reja prej ari e argjendi, në përputhje me kërkesat e reja të tregut. (Shpresa Siqeca)

ARGJILAT (DELTINAT). Shkëmbinj të shkri-fët sedimentarë, me diametër të kokrrizave deri 0.002 mm, në trajtë dheu të shkri-fët ose të ngjeshur, të cilat kur lagen me ujë formojnë një masë plastike, së cilës mund t'i jepen forma të ndryshme dhe, kur të pjekët, gurëzohet dhe i ruan format. Në përbërjen e argjilave zakonisht dominojnë mineralet argjilore (kaoliniti, montmoriloniti dhe iliti), të cilët formohen kryesisht nga tjetërsimi i mineraleve silikate. Përmbajnë pak kuarç, feldshpate, mika etj. Kanë ngjyra të ndryshme, të bardhë deri

në të përhimët, kur janë të pastra, dhe jeshile deri në të zezë. Sipas prejardhjes, dallohen argjilat e mbetura (parësore), të krijuara nga shkatërrimi (alterimi) i shkëmbinjve në vend dhe të sedimentuara (ridepozituara), të formuara nga transportimi dhe depozitimi i materialit të depozituar. Argjilat kanë një përdorim të gjerë si lëndë e parë në industrinë e ndërtimit, kryesisht për prodhimin e tullave, në industrinë e qeramikës dhe çimentos, për prodhimin e tullave zjarrduruese (argjila kaolinike), si material lidhës në fonderi (argjila montmorilonite) dhe në shpimet e naftës, në industrinë kimike, për pastrim vajrash (argjilat bentonite) etj. Kosova ka depozitime relativisht të mëdha të argjilave. Dominojnë argjilat pliocenike, të cilat kanë përhapje në të gjitha fushëgropat tektonike të Kosovës. Ekzistojnë disa vendburime të njohura, ku argjila është shfrytëzuar apo shfrytëzohet në një sasi më të madhe: Gjakovë, Landovicë, Skënderaj, Podujevë dhe Topanicë afër Kamenicës. Ka edhe një numër të shfaqjeve me potencial shfrytëzimi, para së gjithash në pellgun sedimentar të Fushë-Kosovës. (Behxhet Shala)

ARGJIPESHK VIA E KRAJËS. Qendër kish-tare dhe ipeshkvnore mesjetare në bregun e liqenit të Shkodrës, sot në Mal të Zi. Nga shek. X në Krajë ndodhej një vend pelegrinazhi,



RRËNOJAT E KISHËS SË KRAJËS

Kisha e Shën Mërisë së Krajës ose Manastiri i mëvonshëm (1413) me emrin "E Papërlyera e

Krajës” (shek. X; e ripërtërirë në shek. XV), e cila krahasohej shpesh me abacinë benediktine, Shën Mëria e Rotecit (Santa Maria de Rotezo). Në kohën e Balshajve përmendet si “Zoja e Bekueme e Krajës.” Në luftërat me sllavët dhe avarët, deri në pagëzimin e tyre në shek. IX-XI, u shembën shumë institucione kishtarë e ndër to edhe Kisha e Krajës. Skizma kishtarë e vitit 1054 u reflektuan edhe në Kuvendin e Shën Mërisë në Krajë, kuvend që u ndërtua në gërmadhat e kishës së vjetër, po me të njëjtin emër, nga murgu Pjetër në shek. X. Këtu janë admiruar deri në kohët moderne reliktet e Shën Gjon Vladimirit, princit të Dioklesë (i vdekur më 1016), sidomos kryqi i tij. E vendosur në zonën ndërmejt ndikimit ortodoks dhe katolik, kjo qendër ipeshkvnore ka shërbyer si qendër fetare ekumenike. Me rastin e krijimit të Argjipeshkvisë Katolike të Krajës (*Archiepiscopus Crainensis*) në vitin 1446, sipas Milan Shuflajt, selia e saj ishte në Krajën e Shqipërisë. Kjo argjipeshkvi ishte pa sufragane (pa dioqeza në varësi) dhe varej direkt nga Papati. Argjipeshkvi i parë i saj u emërua Teodosius (para vitit 1446). Pas tij, në vitin 1453, erdhi argjipeshkvi i Thermopileve, i quajtur Sabbas. Një vit më vonë, më 1454, argjipeshkëv u emërua Pal Dushi (Dushmani; sipas disave Pal Engjëlli). Pas vdekjes së Pal Dushmanit më 1457, selia e Argjipeshkvisë së Krajës për njëzet vjet mbeti e zbrazët, derisa në krye të saj u emërua dominikani kroat, Andrea Jamometiq, të cilin, pasi e larguan nga selia e vet, e burgosën dhe vdiq në burgun e Bazelit (1483?). Pak kohë pas tij, Argjipeshkvia e Krajës u shua dhe në kohën e sundimit osman ajo u shndërrua vetëm në titullare. Kisha “Shën Mëria” e Krajës ka pasur shumë ngritje dhe rënie deri në shek. XVII, kur osmanët e rrënuan deri në themel dhe e shndërruan në gërmadhë. (Gjon Berisha)

ARGJIPESHK VIA E SHKODRËS. Njëra nga qendrat kishtarë më të vjetra shqiptare të rritit katolik në veri të Shqipërisë. Nga fundi i shek. IV, Shkodra del për herë të parë në burime historike si një ipeshkvi (*episcopus civitates Scodrorum*) dhe më vonë si qendër e provincës së Prevalit, e cila ishte nën juridiksionin kishtar të Romës, që drejtohej nëpërmjet vikariatit të saj në Selanik. Në vitin 535, Ipeshkvia e Shkodrës bie nën varësinë e Argjipeshkvisë Justiniana Prima, e cila varej drejtpërdrejt nga

papa. Sipas “*Illyricum Sacri*”, ipeshkvi i parë i Shkodrës ishte Basso, i cili ka shërbyer në kohën e papës Siriçi (Siricius, 384-399). Emrat e argjipeshkvijve të Shkodrës, të cilësuar si të provincës së Prevalit, përmenden në mënyrë të vazhdueshme nga mesi i shek. IV deri në fillimin e shek. VII. Ndërkaq, nga shek. VII deri në mesin e shek. XII, emrat i ipeshkvijve të Shkodrës janë të panjohur. Në shek. VIII Shkodra ishte sufragane e Mitropolisë së Durrësit dhe kjo u rikonfirmua edhe në shek. X. Gjatë riorganizimit të Argjipeshkvisë së Tivarit, Ipeshkvia e Shkodrës ishte në kuadër të saj. Me dobësimin e pushtetit bizantin në vitin 1022, u shkëput nga juridiksioni i Mitropolisë së Durrësit dhe me krijimin e Argjipeshkvisë së Tivarit më 1034, Ipeshkvia e Shkodrës, së bashku me ipeshkvijtë e tjera të Shqipërisë Veriore e Veriperëndimore u bënë sufragane të Kishës së Tivarit. Në këtë pozitë Shkodra do të vazhdojë të jetë edhe pas pavarësimit përfundimtar të Tivarit nga Raguza në shek. XIII. Në periudhën ndërmjet viteve 1063-1886 janë të njohur emrat e 53 ipeshkvijve të Shkodrës. Pas një periudhe të gjatë intermediare prej 540 vitesh, më 15 mars 1867, me vendimin e papës Piu XI, Shkodra e fitoi të drejtën e Selisë së Argjipeshkvisë Mitropolitane me pozitën “*aeque principaliter*” karshi Tivarit. Imzot Karlo Pooten u transferua nga Tivari dhe mbajti titullin e juridiksionit mbi të dyja mitropolitë, deri në vitin 1886, kur ndahet krejtësisht nga Argjipeshkvia e Tivarit dhe në krye të Argjipeshkvisë Mitropolitane të Shkodrës u emërua imzot Pashko Guerini, me tri dioqeza sufragane: Lezhën, Sapën dhe Dioqezën e Pultit. Në Argjipeshkvinë e Shkodrës dhanë kontribut edhe mjaft shqiptarë nga Kosova, si Pjetër Bogdani etj. (Gjon Berisha)

ARGJIPESHK VIA E TIVARIT. Institucion kryesor administrativ i kishës katolike, që përfshin besimtarët katolikë të Malit të Zi, pa territorin e Dioqezës së Kotorrit. Si qendër kishtarë ekzistonte që në shek. V. Në vitin 599 përmendet si ipeshkvi nën juridiksionin kishtar të metropolisë së Dioklesë (Zetës), dikur kryeqytet i provincës romake Prevalitana. Nga shekulli VIII ishte nën metropolinë e Durrësit. Si pasardhëse e metropolisë së Dioklesë, ipeshkvia e Tivarit është përmendur së pari në shekullin IX, gjatë sundimit të perandorit bizantin, Leonit VI (886-912). Në



SELIA E ARGJIPESHKVISË SË TIVARIT

fillim të shekullit X përkohësisht u vendos nën metropolinë e Solonës (Splitit) dhe prej shek. XI (1022) ishte nën juridiksionin e Argjipeshkvisë së Raguzës (Dubrovnikut), deri në kohën e protopapës Klementit III (1080-1100), i cili i konfirmoi të drejtat argjipeshkvnore dhe metropolitane të Tivarit në vitin 1089. Në këtë kohë Argjipeshkvia e Tivarit kishte 12 kisha sufragane, në mesin e të cilave bënin pjesë edhe Ulqini, Kotorri, Shkodra, Drishti, Pulti, Shasi, Arbëri, Prizreni etj. Mosmarrëveshjet me Argjipeshkvinë e Raguzës rreth juridiksionit kishtar përfunduan në vitin 1252, në favor të Argjipeshkvisë së Tivarit, e cila u pavarësua përfundimisht. Më 1189, u pushtua nga Stefan Nemanja, me ç'rast u rrit roli i kishës ortodokse-sllave. Gjatë sundimit të Balshajve dhe venedikasve, roli i Tivarit u gjallërua përsëri deri me rënien nën sundimin osman në vitin 1571, kur selia e saj në katedralen e Shën Gjergjit më 1579 u kthye në xhami. Gjatë sundimit osman, argjipeshkviutë e saj vepruan jashtë selisë, kryesisht në zonat fqinje, deri nga mesi i shek. XIX, kur u rivendosën përsëri në Tivar. Kur më 1622 në Romë u themelua Kongregata për Përhapjen e Fesë (Congregatio De Propaganda Fides), brenda juridiksionit të saj hyri edhe Tivari. Me marrëveshjen e Vjenës (1815), Austria e fitoi të drejtën e protektoratit mbi katolikët e Argjipeshkvisë së Tivarit. Argjipeshkvi i fundit i periudhës osmane, Karl Poteni, më 1867 e transferoi përkohësisht selinë në Shkodër, duke kombinuar kështu

institucionin kishtar Tivar-Shkodër. Pas Kongresit të Berlinit (1878), përkatësisht me Konkordatin në mes të Malit të Zi dhe Vatikanit (1886), zona e juridiksionit shpirtëror të Argjipeshkvisë u reduktua në zonën brenda kufijve të sotëm të Malit të Zi. Me këtë rast u bë edhe ndarja e Argjipeshkvisë së Tivarit dhe e Shkodrës. Më 1857 imzot Karl Poteni e ndërtoi katedralen e “Zojës së Papërlyer” në pjesën e vjetër të qytetit të quajtur Gretva. Gjatë Mbretërisë së ish-Jugosllavisë, Argjipeshkvia e Tivarit ishte drejtpëdrejt nën juridiksionin e Selisë së Shenjtë.

Gjatë periudhave të ndryshme, Argjipeshkvia e Tivarit pati shtrirje shumë të madhe: në lindje arriti deri në Bullgari, në veri deri të Sremi, ndërsa në perëndim deri në Bosnjë. Nën juridiksionin e saj, gjatë mesjetës dhe më vonë, kanë qenë edhe viset shqiptare të Shqipërisë Veriore, të Kosovës, të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe të Serbisë. Selia e Argjipeshkvisë është udhëhequr nga klerikë të ndryshëm, më së shumti shqiptarë, duke përfshirë edhe ata nga Kosova, si imzot Pjetër Mazreku, që udhëhoqi gjatë viteve 1628-1634 dhe argjipeshkvi aktual, imzot Zef Gashi, i cili e udhëheq këtë argjipeshkvi që nga viti 1998. Aktualisht Argjipeshkvia e Tivarit ka tre dekanate (Tivari, Ulqini dhe Podgorica) me 19 famulli varëse, me klerin dioqezian, rregulltarët françeskanë dhe salezianë, motrat françeskane të Zojës së Papërlyer me seli në Cetinë etj. (Gjon Berisha)

ARIFAJ Ardian (1973). Gazetar. Lindi në Pejë. Shkollimin e kreu në Prishtinë, ndërsa studimet për diplomaci i mbaroi në Londër. Me gazetari filloi të merret në vitin 1997, si gazetar në “Koha ditore”, e cila sapo kishte filluar të botohej. Nga viti 1999 deri më 2003 punoi si redaktor i lajmeve, më pas la gazetarinë dhe nisi aktivitetin në shoqërinë civile, pastaj në organizatat ndërkombëtare dhe, së fundi, në politikë. Gjithashtu ligjëroi për gazetari në Institutin e Medies në Kosovë. Së fundi mori detyrën e këshilltarit politik të Presidentit të Kosovës. (Besim Abazi)

ARIFAJ Shaban (1952-). Gazetar, spiker. Lindi në Istog. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1975 filloi

punë spiker në Radio Prishtinë, ku punoi për shumë vjet në redaksinë e lajmeve. Pas vitit 1990 u angazhua si korrespondent për emisionet në gjuhën shqipe të radiove të huaja, për emisionin për Kosovën të Radio-Zagrebit dhe të Televizionit Shqiptar (1985-1999). Nga viti 2000 ishte redaktor përgjegjës i programit informativ të Radio Kosovës, më pas kryeredaktor dhe së fundi drejtor i sektorit për trajnimin e personelit. Publikoi disa libra nga fusha e publicistikës dhe letërsisë: “Gjuha, zëri dhe figura në radiotelevizion” (2016), romanin “Katralligu” (2016) etj. (Shaqir Foniqi)

ARIFI Fatmir (Zijadin) (1973-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc (UÇPMB). Lindi në Bukoc të Preshevës. Kreu shkollën e mesme në Preshevë, ndërsa studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1990 iu bashkua Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Në vitin 1997 u bashkohet grupeve guerile të UÇK-së. Më 1998 u inkuadrua në njësinë “Fenix” të Shtabit të Përgjithshëm (SHP) të UÇK-së. Po këtë vit u caktua ndërlidhës në mes të SHP të UÇK-së dhe grupeve ushtarake të Luginës së Preshevës. Ishte njëri ndër themeluesit e Radios “Kosova e lirë”. Në vitin 2000, me daljen në skenë të UÇPMB-së në Luginë të Preshevës, F. Arifi ishte njëri nga drejtuesit e saj dhe u emërua përgjegjës i sektorit për informim. Për veprimtarinë politike u dënua tri herë në mungesë nga Serbia. (Jeton Arifi)

ARIFI Iliriana (1975-). Regjisore. Lindi në Shtime. Studimet për regji teatri i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin “Dodona” inskenoi shfaqjet: “Pianisti dhe kukulla”(2002), “Romeo dhe Zhuljeta” (2003) dhe “Rikardi i III” (2007), pastaj, me realizimin e shfaqjeve, vazhdoi në Teatrin Kombëtar të Prishtinës me: “Mosmarrëveshja” (2004), “Udhësi i Majës së Lartë” (2010), “Cubi i Kukurrecit” (2011), dhe “Dashnori i nanës sime”, “Dardha pas bunarit”, “Kohë pa ngjarje” etj. Për disa nga këto shfaqje mori çmime në festivalet e teatrove në Gjilan, Podujevë etj. Realizoi edhe shfaqje të tjera në teatrot e Pejës, Prizrenit, Ferizajit dhe Gjilanit. (Fadil Hysaj)

ARIFI Murtezan (1950-2001). Poet, shkrimtar. Lindi në fshatin Llërcë të Tetovës. Mbaroi shkollën fillore dhe të mesmen në Tetovë, kurse të lartën për gjuhë dhe letërsi shqipe, në Shkup. Punoi si mësues. Me shkrime letrare, kryesisht poezi, nisi të merret që në moshë të re. Ishte pjesëmarrës në shumë konkurse letrare të organizuara nga revistat në gjuhën shqipe (“Jeta e re”, “Zëri i rinisë” etj.) dhe fitues në këto konkurse. Poezitë e tij u botuan në të gjitha revistat dhe gazetat shqipe të Kosovës dhe të Maqedonisë. Botoi veprat: “Lulet e acarit” (1997), “Syri i zemrës” (2001), “Barka yjore” (2002). Ishte njëri ndër themeluesit e revistës për art dhe kulturë “Brezi 9”. (Fatmir Sulejmani)

ARIFI Qerim (1946-1990). Poet, përkthyes. Lindi në Preshevë, ku kreu shkollën fillore. Në Prishtinë kreu Shkollën Normale, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës. Një kohë të shkurtër ishte arsimtar, pastaj gazetar te “Zëri i rinisë”. Kaloi një jetë të mundimshme, me fëmijëri skamnore dhe rininë e rënduar nga sëmundja. Kjo u reflektua edhe në poezinë e tij. U nda herët nga jeta. Botoi vëllimet me poezi “Kujtime” (1970), “Nokturno” (1983), “Mbyllur në urnë” (1987), “Fatamorganë” (1984), “Rekuiem për kalanë”, si dhe përkthyeu “Katër kuartetet” e T. S. Eliotit. (Eqrem Basha)

ARIFI Teuta (1969-). Shkrimtare, mësimdhënëse universiteti, politikane. Lindi në Tetovë, ku e kreu shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Shkupit, ku mbrojti edhe tezën e dokotratës. Ka qenë ligjëruese në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Shkupit dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Disa vjet ishte gazetare-korrespondente e Radios “Doççe Velle”, programi në gjuhën shqipe. Është autore e librave: “Gjeografia ime” (poezi, 1996); “Feminizmi ekzistencialist” (studim, 1997); “Gruaja në trendet bashkëkohore në Maqedoni” (studime, 1997) dhe “Shtatë net magjike” (tregime, 1998). Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përfshirë në antologji dhe panorama poetike. Në dy mandate ka qenë deputete dhe ministre e Integrimi Evropian në Qeverinë

e Maqedonisë. Së fundi u zgjodh kryetare e komunës së Tetovës. (Salajdin Salihu)

ARIFI-BAKALLI Emine (1951-). Historiane, profesore universiteti. Lindi në Babush të Muhaxhirëve të Ferizajt. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, studimet për histori



EMINE
ARIFI-BAKALLI

i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku më pas kreu studimet pas-universitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1984). Nga viti 1974 punoi pedagogë në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të

UP-së. Në fillim të viteve '90 u angazhua në mbrojtje të autonomisë së UP-së, kundërshtoi masat e dhunshme të Serbisë dhe u përjashtua nga puna (dhjetor 1991). Më pas kontribuoi në organizimin e mësimin paralel dhe pavarësimin e shkollës shqipe në Kosovë. Ishte redaktore për shkencat shoqërore në këshillin botues të UP-së, anëtare e grupit të ekspertëve për planet dhe programet mësimore në Ministrinë e Arsimit. Aktualisht është anëtare e redaksisë për historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në shek. XX të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Tiranë. Botoi punime shkencore për zhvillimet historike të periudhave të ndryshme, veçmas për periudhën midis dy luftërave botërore. Ka botuar monografitë "Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939" (1997), "Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare" (2011), "Përballje historiografike" (2015). (Sulltane Ukaj)

ARIU I MURRMË. (*Ursus arctos*) Është i përhapur në zonat malore në disa kontinente, ndërsa në Kosovë aktualisht haset në masivet malore të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna. Ushqehet kryesisht me fruta të pyllit, por edhe me vezë shpendësh, me gjitarë, me milingona dhe me mjaltë. Pesha trupore shënon variacione në stinë të ndryshme të vitit. Është karakteristike se ariu i murrmë në Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr peshon rreth 350 kg. Është kafshë e vetmuar dhe e natës. Haset në grupe të mëdha, kur ka ushqim të mjaftueshëm. Jeton në pyje të larta të vjetra dhe të qeta, në vise kodrinore në lartësi nga 1,000-2,000 metër. Dimëron në vende që i konsideron të fshehura,

nga të cilat ndonjëherë del edhe gjatë stinës së dimrit. Çiftëzimi bëhet pas moshës katërvjeçare. Në Kosovë, sikundër edhe në vendet e tjera të Ballkanit, ariu i murrmë është futur në listën për ndalim gjuetie. (Ibrahim Muja)

ARKEOLOGJIA ANTIKE. Disiplinë e arkeologjisë. Studion periudhën nga paraqitja e shkrimit dhe përfundon me rënien e Perandorisë Romake në vitin 476. Ka mendime se përfundimi i saj bie në shek. IV dhe lidhet me ndarjen e Perandorisë Romake në atë të Lindjes dhe të Perëndimit. Trajton qytetërimet e zhvilluara pranë lumenjve Tigër, Eufrat dhe Nil (Mesopotami dhe Egjipt), ato të zhvilluara rreth detit Egje (Minoik dhe Mikenas), atë fenikas, grek dhe romak. Termi antik merr kuptim më të ngushtë, kur i referohet epokës historike të botës klasike (Greqi, Romë, Azi e Vogël, Mesdhe). Ajo trajton dhe studion qytetërimet e lashta, përmes gërmimit dhe analizës së gjurmëve të ruajtura në rrënojat e vendbanimeve, vendvarimeve, ndërtimeve, objekteve të përdorimit të përditshëm, veprave të artit, monedhave etj. Arkeologjia antike mbështetet shumë në burimet e shkruara antike, andaj studimi i gjuhëve të lashta, sidomos i greqishtes dhe latinishtes, paraqet bërthamën e zbatimit të saj. Sikundër arkeologjia biblike, edhe ajo antike kombinon tekstet antike me të dhënat arkeologjike, për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ndryshme historike dhe antropologjike. Ky term, edhe pse i vonë në fjalorin e shkencave humane, gjeti përdorim të gjerë në gjysmën e dytë të shek. XIX. Në hapësirat ilire kjo periudhë zë fill në shek. VII-VI p.e.r. dhe përkon me themelimin e kolonive helene të Epidamnit, Apolonisë dhe Orikumit. Karakterizohet me themelimin e qendrave qytetare ilire nga shek. V p.e.r., me pushtimet romake, përhapjen e krishterimit, përfshirjen e territoreve ilire nën administrimin e Bizantit, si dhe me sulmet barbare dhe vendosjen e një pjese të tyre në territoret ilire. Arkeologjia antike në Dardani zë fill nga shek. IV p.e.r. dhe kjo disiplinë ishte e para që filloi të zhvillohej në Kosovë, me identifikimin dhe gërmimin e Ulpianës te Graçanica, Municipium DD te Soçanica, Vendenisit te Podujeva etj. (Arben Hajdari)

ARKEOLOGJIA MESJETARE. Degë e arkeologjisë që studion zhvillimin e shoqërisë

gjatë periudhës mesjetare. Studimi bëhet në bazë të të dhënave të kulturës materiale, duke plotësuar kështu mungesën e burimeve të shkruara për shumë aspekte të panjohura të jetës gjatë mesjetës. Që nga viti 1821, me krijimin e “Shkollës së hartave” në Francë, ajo u orientua në mënyrë të veçantë në historinë mesjetare. Në Britani u krijua para vitit 1850, kur u hap departamenti i antikitetëve britanike dhe mesjetare në Muzeun Britanik, kurse nga viti 1956 u formua “Shoqëria e Arkeologjisë Mesjetare”. Themeluesit e arkeologjisë mesjetare konsiderohen Michel de Buard, i ndjekur nga Gabrielle Demians d’Archimbaud dhe Jean-Marie. Botimet e para në arkeologjinë mesjetare datojnë nga vitet ‘70 të shek. XX. Interes të përtërirë pati nga viti 1960, kur nisi fokusimi në mbetjet arkeologjike mesjetare, të ndeshura gjatë shkatërrimit të objekteve të vjetra në qytete. Për hapësirën kohore që përfshin arkeologjia mesjetare ekzistojnë ende polemika, Kryesisht mbisundon teza se arkeologjia mesjetare përfshin periudhën prej rënies së Perandorisë Romake (476) deri në fillimin e epokës moderne dhe më tej. Në aspektin kronologjik, ndahet në arkeologjinë e mesjetës së hershme, të mesjetës së zhvilluar dhe të mesjetës së vonë. Në kuptimin më të gjerë u referohet mbetjeve arkeologjike të periudhës bizantine, deri te ato paramoderne. Nisi të zhvillohet me ngritjen e vetëdijes për njohjen e identitetëve të popujve të Europës, siç ishin gotët, saksonët, vikingët, lombardët, frankët, ilirët/arbrit etj. Arkeologjia mesjetare u zhvillua dhe në Kosovë, por deri në vitin 1999 u përqendrua vetëm në lokalitetet dhe objektet që mendohej se u takonin sllavëve, duke lënë anash lokalitetet dhe çështjet që kishin të bënin me vazhdimësinë ilire dhe dardane. Pas luftës së fundit në Kosovë u intensifikuan studimet edhe të vendbanimeve kodrinore dhe të kishave të mesjetës së hershme. (Arben Arifi)

ARKEOLOGJIA NË KOSOVË. Hulumtimet arkeologjike të zhvilluara në Kosovë ndahen në tri faza: 1. Para Luftës së Dytë Botërore; 2. Vitet 1950–1999; dhe 3. Pas luftës 1999. Historia e hulumtimeve sistematike nisi nga vitet 50 të shek. XX dhe ishte shprehje e zhvillimeve politike dhe e luftës në fund të shek. XX. Në fazën e parë njihen studimet e A. Budajt në perëndim të Rrafshit të Dukagjinit, gërmimet e ushtarëve austriakë në tumën e Njebishtës,



NJË EKSPEDITË ARKEOLOGJIKE NË KOSOVË

ato amatore të atë Shtjefën Gjeçovit në Has dhe të dhënat e autorëve të ndryshëm nga viti 1610. Në këtë periudhë janë ofruar të dhëna të shumta arkeologjike, sidomos nga A. Evans (1885).

Faza e dytë (1950-1999) përfshin periudhën e ish-Jugosllavisë, me nënfazat a. 1950-1970, b. 1970-1981 dhe c. 1981-1999. Nënfaza a (1950-1970) shënon themelimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe disa gërmime arkeologjike nga arkeologët serbë, të përqendruara në lokalitetet neolitike të periudhës romake dhe të shtetit mesjetar serb (Tjerrtorë, Runik, Ulpianë, Municipium DD, Novobërdë etj.). U gërmuan edhe tumat në Ujëz, Shirokë e Dubiçak. Nënfaza b (1970-1981) shënon periudhë të suksesshme të hulumtimeve edhe si rezultat i disa hapave liberalizues politikë. Këto hulumtime u përqendruan edhe në tumat dhe vendbanimet ilire (Romajë, Rogovë, Porodime, Llashticë, Gërllicë, Gadime e Epërme, Cernicë etj.) dhe në to u përfshinë dhe arkeologë shqiptarë. Këtë fazë dhe fazat paraprake i karakterizon mungesa e gërmimeve të fortifikatave kodrinore të antikës së vonë, si mundësi e studimit të vazhdimësisë iliro-dardane. Nënfaza c (1981-1999) shënon shfrytëzimin e arkeologjisë për nevoja politike serbe kundër shqiptarëve të Kosovës dhe mund të karakterizohet si “arkeologji e luftës së ftohtë”. Fillimisht u bënë përpjekje “shkencore” për t’i paraqitur dardanët si joilirë, pastaj dardanët si popull i pazhvilluar e deri tek akuzat nga viti 1981, se shqiptarët shkatërruan varret mesjetare “sllave” të Vërmicës. Në vitin 1998 u dërgua në Beograd dhe thesari arkeologjik nga muzetë e Kosovës për ekspozitën “Thesari arkeologjik i Kosovë dhe i Metohisë”, i cili ende nuk është kthyer.

Faza III (pas vitit 1999) solli epokë të re për hulumtimet arkeologjike, pas ripërtëritjes së institucioneve të trashëgimisë kulturore, fuqizimit të aftësive profesionale dhe sigurimit të pajisjeve elementare dhe themelimit të Institutit Arkeologjik të Kosovës (2003). Faza emergjente dhe e rekonstruktimit, e udhëhequr nga bashkësia ndërkombëtare, nuk përfshiu arkeologjinë dhe trashëgiminë kulturore si prioritet. Kjo bëri që vetëm në vitin 2002 të nisnin disa gërmime arkeologjike në Vlashnjë, Çifllak e Radavc dhe më 2003 në Hisar të Suharekës. Viti 2004 dhe më pas shënon gërmime më intensive në Graboc, Korishë, Kalanë e Prizrenit, Çifllak, Rogovë, Jahoc, Harilaq, Kasterc, Poslishtë, Grashticë, Gradinë të Pejës, Ponoshec, Llashticë, Keqekollë, Bllacë, Banjë e Malishevës, Reshtan, Dobrevë, Vushtri, Nishor, Vulljakë, Ticë, Podrigë, Cernicë, Vrellë, Dërsnik, Trudë, Barilevë, Lubozhdë, Kulinë, Bellaqefc etj. Në vitin 2006 rinisën hulumtimet në Ulpianë, si bashkëpunim i parë ndërkombëtar midis Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit “Pierre Mendes” (Francë), me përfshirje edhe të studentëve ndërkombëtarë (2006-2010). Në Ulpianë nisi gërmimet dhe Muzeu i Kosovës dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve i komunës së Prishtinës. Në vitet 2009-2012 veproi dhe Instituti i Frankfurtit (Gjermani) në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Kosovës, ndërsa më 2012 u përfshi dhe Universiteti “Mimat Sinan” (Turqi) si dhe Muzeu i Bohumit (Gjermani). Krahas specializimeve të kuadrove jashtë vendit, hap i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkencore është themelimi i drejtimit të arkeologjisë (dega e antropologjisë) në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (2014). Ndërkohë nis bashkëpunimi i faktorëve relevantë dhe bërja e politikave nacionale në fushën e arkeologjisë, duke respektuar ligjet e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare. (Edi Shukriu)

ARKEOLOGJIA PARAHISTORIKE. Degë e arkeologjisë, e cila ka për qëllim studimin e shoqërisë njerëzore para lindjes së shkrimit dhe burimeve historike. Ka për objekt studimi më shumë se 99% të historisë së njeriut, që nga shfaqja e tij rreth 7 milionë vjet më parë deri në mijëvjeçarin IV p.e.r., kur lindi shkrimi në Lindjen e Mesme. Kufiri fundor i parahistorisë ndryshon shumë në rajone dhe

kultura të ndryshme: rreth 3,000 vjet p.e. r. në Sumer e Egjipt, shek. XIX në Guinenë e Re, por vazhdon ende në rajone të caktuara. Kjo arkeologji trajton tema qendrore të historisë së njerëzimit, si origjinën dhe evolucionin e njeriut, shfaqjen e njeriut modern dhe të kulturës së tij, lindjen e bujqësisë dhe të jetës sedentare, shfaqjen e xehetarisë, qytetërimet e hershme etj. Nga shek. XIX trashëgoi ndarjen kronologjike konvencionale, të njohur si “sistemi i tri epokave”: të gurit, të bronzit dhe të hekurit. Arkeologjia parahistorike u zhvillua edhe në Kosovë nga vitet ‘60 të shek. XX, me përqendrim fillestar në lokalitetet neolitike (Runiku te Skënderaj, Tjerrtorja te Prishtina, Fafosi te Mitrovica, Glladnica te Graçanica etj.) dhe pastaj të atyre eneolitike, e deri te ato të epokës së hekurit (Gadime e Epërme, Hisar i Suharekës dhe Kasterc, Cernicë, Shirokë, Dibiçak, Romajë, Llashticë, Porodime etj.). Hulumtimet u shtuan pas vitit 2000, me gërmime reviduese dhe të lokaliteteve të reja. (Lorenc Bejko)

ARKITEKTURA POPULLORE E FSHATIT (shek. XVIII-XIX). Zë vend të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore-materiale të Kosovës dhe në arkitekturën popullore shqiptare në përgjithësi. Në varësi nga faktorët natyrorë, fiziko-geografikë, shoqëror-ekonomikë, socialë dhe politikë, në Kosovë janë ndërtuar variante të ndryshme të arkitekturës banesore fshatare. Ndërtimet më të vjetra të këtij lloji, që ende ruhen në Kosovë, i përkasin periudhës së shek. XVIII-XIX. Ato paraqesin një vazhdimësi si në aspektin planimetrik dhe funksional, ashtu dhe në atë të strukturës dhe teknikës së murimit dhe të dekorimit. Ndërtimet e këtilla, qofshin të thjeshta apo monumentale, kulla tri a katërkatëshe, me ambiente funksionesh të ndryshme, kanë vlera dhe rëndësi për historinë e arkitekturës fshatare. Nga aspekti i skemës kompozicionale, në Kosovë paraqiten disa tipa të ndërtimit të banesave të vjetra fshatare: shtëpi me trarë, me qoshk në ballin kryesor, me treme, oda të burrave, me çardak, si dhe kulla si banesa të fortifikuara familjare. Për nga rëndësia dhe vlerat kulturore-arkitekturale veçohen banesat e tipit çardak dhe të tipit kullë. Këto ndërtime u ngritën nga mjeshtërit popullorë shqiptarë me përvojë, kryesisht të “shkollës dibrane”, të cilët u bënë sinonim i ndërtimitarisë në Kosovë dhe më gjerë. Eksterierët, veçmas pamjet kryesore

të godinave paraqesin pjesën më të bukur të ndërtimeve. Ndërtimet fshatare veçohen edhe me dekorime të brendshme, të realizuar kryesisht në odën e mysafirëve. Dekorimet bëheshin nga mjeshtrit lokalë, por edhe nga anëtarët e familjes. Baza e këtyre ndërtimeve ishte kryesisht kënddrejtë dhe kishin çati katërujëse, të mbuluara me qeramidhe tradicionale. Objektet e banimit kishin edhe ndërtimet ndihmëse, që së bashku përbënin kompleksin rural arkitekturor. (Fejaz Drançolli)

ARKITEKTURA POPULLORE E QYTETIT (shek. XVIII-XIX). Janë ndërtime popullore, objekte të arkitekturës së vjetër të banimit, që u ruajtën në Kosovë dhe i përkasin trashëgimisë



ENTERIER I NJË SHTËPIE QYTETARE

së saj kulturore. Kjo ndërtimtari e tipit oriental dhe ballkanik, me elemente vendore, veçohet edhe në pikëpamje kompozicionale, konstruktive, funksionale dhe artistike. Këto banesa të vjetra qytetare, kryesisht të mbetura në gjendjen fillestare, janë realizuar nga mjeshtrit shqiptarë dhe i janë dedikuar popullsisë shqiptare. Banesat qytetare paraqiten të veçuara ose si komplekse banimi. Si komplekse të këtilla paraqiten në qytetin e Pejës. Në kuadër të këtyre ndërtimeve paraqitet banesa e tipit kullë, ato të tipit me qoshk, me ballkon, me hajat, me çardak, përfshirë edhe ndonjë variant tjetër. Më të përhapura ishin këto të tipit me qoshk dhe çardak. Për ndërtimin e këtyre banesave qytetare në zona fushore, e në raste të veçanta edhe në zonat e pjerrëta dhe kodrinore, si në Nënkanlanë e Prizrenit, u përdor material i përzier, si gurë, dru dhe qerpiç. Banesa e vjetër qytetare, pos tjerash, veçohet me daljet ose ancaqët, erkerët e “guximshëm”, me harmonitë e dritareve dhe strehët e gjëra, të cilat në disa raste për-

forcohen me pajanda. Të gjitha këto ndikojnë në plasticitetin dhe dritë-hijen e këtyre ekzemplarëve të banesave të vjetra. Përveç eksterierit, veçohet me vlera artistike edhe enterieri me musandrat, banjat, dollapët, dyert dhe raftet e realizuar në drugdhendje. Duhet veçuar tavanet me vana dhe tavanet në formë trëndafil. Ka pasur dekorime edhe në teknikën e stuko-relievit. Disa nga këto banesa kanë pasur edhe ngrohje me avull. Ekzemplarë të banesave të këtilla ka pasur në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Vushtrri dhe Mitrovicë, por pa mjedisin e tyre fillestar. (Fejaz Drançolli)

ARKIVI I KOSOVËS. Është institucion më i lartë i arkivave të Kosovës, i cili me emrin Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës vepron në kuadër të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht



ARKIVI I KOSOVËS

të Zyrës së Kryeministrit. Shërbimi arkivor në Kosovë në mënyrë të organizuar si institucion është i njohur nga 21 marsi i vitit 1951, sipas vendimit për themelimin e Arkivit Shtetëror Krahinor me seli në Prishtinë, i aprovuar në Kuvendin e atëhershëm të Krahinës së Kosovës. Nga viti 1968 institucioni emërtohet Arkivi i Kosovës. Po në këtë vit u themeluan edhe arkivat ndërkomunale në Prizren, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe në Gjilan. Nga viti 1974, Arkivi i Kosovës vepron si institucion i pavarur. Me suprimimin e autonomisë së Kosovës nga Kuvendi i Serbisë (1989), Arkivi i Kosovës u administrua me masa të dhunshme, të shoqëruara edhe me ndërrimin e emrit (Arkivi i Kosovës dhe Metohisë, 1990-1999). Nga 21 qershori 1999, Arkivi i Kosovës administrohet nga organet legale. Më 2003 u aprovua ligji për lëndën arkivore dhe arkivat, në mbështetje të të cilit u themelua Drejtoria e Arkivave të Kosovës.

Në depo të objektit qendror në Prishtinë, si dhe nëpër gjashtë arkiva ndërkomunale, ka gjithsej 7, 200 metra gjatësi të lëndës arkivore, apo gjithsej rreth 1,200 fond-krijues. Arkivi i Kosovës boton organin shkencor-profesional “Vjetari” dhe ka laboratorin për restaurimin dhe digjitalizimin e dokumenteve. Përveç dokumenteve origjinale, që përfshijnë periudhën më të vonë historike, ruhen edhe faksimile e mikrofilma të periudhave më të hershme, të vjela nga arkiva të njohura botërore. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës zhvillon bashkëpunim të rregullt ndërkombëtar në fushën e arkivistikës me arkivat e Maqedonisë, të Shqipërisë, të Bullgarisë, të Kroacisë, të Austrisë dhe të Malit të Zi. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është anëtare e Këshillit Ndërkombëtar Arkivor (ICA) me seli në Paris, që vepron në kuadër të UNESCO-s. (Ramë Manaj)

ARLLATI Behar (1964-). Etnomuzikolog. Lindi në Gjakovë. U diplomua në departamentin e muzikës, drejtimi teorik-pedagogjik i Fakultetit të Arteve në Prishtinë. Më pas iu kushtua traditës muzikore urbane. Ishte bashkëpunëtor i Festivalit “Zërat e botës” (Suoni dal mondo), organizuar për shumë vjet nga Ministria e Kulturës e Italisë dhe Universiteti i Bolonjës. Kreu studimet master të nivelit të dytë në Tiranë (2012), ku mbrojti tezën për këngët qytetare gjakovare. Më pas i vijoi studimet e doktoratës në të njëjtin institucion. Është mësimdhënëse në Shkollën e Mesme të Muzikës në Gjakovë, autor shkrimesh botuar brenda e jashtë vendit, pjesëmarrës konferencash me tema nga folklori në Kosovë e Shqipëri, si dhe autor i monografive: “Tradita muzikore në Gjakovë” (2014), “Mazllom Mejzini, jeta dhe vepra” (2014), “Xhavit Xhepa, një jetë në skenë” (2015) etj. (Zeqirja Ballata)

ARNAUT. Emërtimi i shqiptarëve nga turqit, ndonëse turqishtja e sotme e përdor formën arnavut. Ky etnonim lidhet etimologjikisht (me ndërmjetësimin e greqishtes arvanit-arnaut, si metatezë) me fjalën arbën. Fjala arnaut ka shenjuar edhe ushtarët në njësitet mercenare në Perandorinë Osmane, të përbëra kryesisht nga shqiptarët, por edhe nga grupet e tjera etnike. Në gjuhët sllave të jugut ky term tash është pak i vjetruar dhe ndonjëherë ka dhe konotacion pezhorativ. Është përdorur në shtypin përëndimor në shekullin e fundit të

Perandorisë Osmane, kryesisht me konotacion negativ, ndërsa Albanian ka qenë fjala neutrale. Sot përdoret edhe për të shënuar banorët e Turqisë me origjinë shqiptare (arnavut). Në Siri shumë familje me origjinë shqiptare njihen me mbiemrin Arnaut. (Drita Tërshani)

ARNAUTI Abdulkadir (1928-2004). Haditholog, studiues i fesë islame. Lindi në fshatin Vrellë të Istogut. Në vitin 1932 familja e tij u shpërngul nga Kosova dhe përfundoi në Damask të Sirisë. Arsimimin e mori në kryeqytetin e Sirisë, ndërsa mësoi edhe zejen e orëtarit. Për një periudhë të gjatë bëri detyrën e imamit dhe vaizit në xhami dhe lagje të ndryshme të Damaskut, derisa u ndalua nga ana e pushtetit. Nga vitet 1952-1960 e më pas punoi si mësimdhënëse i lëndës së Kuranit dhe Hadithit. Vinte nga lagjia shqiptare e Damaskut “Harret Arnaut” dhe gjerësisht ishte i njohur me mbiemrin “Arnaut”. Është autor i shumë veprave dhe i punimeve shkencore, kryesisht në fushën e Hadithit. Bëri redaktimin dhe korrektimin profesional të punës së dijetarëve të gjeneratave të mëhershme, duke aplikuar kriteret shkencore bashkëkohore. Në angazhimet shkencore një kohë bashkëpunoi shumë afër me dijetarin e mirënjohur shqiptar, Shuajb Arnautin, i cili po ashtu jetoi në Damask. Disa herë e vizitoi Kosovën edhe në periudhën e pushtetit komunist, edhe pas vitit 1999. Vdiq në Damask. (Sulejman Osmani)

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS. Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës shkollore në klasë të rregullta, pa dallim, me theks të veçantë të fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët arsimoheshin në shkolla speciale. Forma të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë kishte edhe më parë, por kjo filozofi dhe praktikë e re dhe më e plotë e arsimit aktualizohet pas vitit 2000. Pasurohet gradualisht dhe bëhet pjesë integrale e të gjitha politikave të arsimit të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë. Gjithëpërfshirja është parim bazë i kornizës së kurikulës së Kosovës (2011). (Naser Zabeli)

ARSIMI I DETYRUESHËM. Detyrim ligjor i fëmijëve të moshës së caktuar për vijimin e mësimin në shkollë. Arsimi i detyrueshëm ofron dituri, shkathtësi, shprehje dhe kulturë të përgjithshme. Me legjislacionin kosovar, arsimi i detyrueshëm është nëntëvjeçar dhe ka të bëjë

me përfshirjen e të gjithë nxënësve, nga moshë 6-15 vjeç, në shkollën fillore pesëvjeçare dhe në shkollën e mesme të ulët katërvjeçare. Përfshin, gjithashtu, edhe arsimin e personave që e kanë përfunduar arsimin në sistemin e vjetër të arsimit të detyrueshëm tetëvjeçar (4+4). Arsimi i detyrueshëm në Kosovë organizohet, kryesisht, në institucione publike, por edhe në ato private. Në institucionet publike është pa pagesë dhe financohet nga buxheti i shtetit. Me këtë garantohet e drejta e të gjithë fëmijëve të moshës shkollare për t'u arsimuar. Mësimi organizohet në gjuhën shqipe, serbe, kroate, turke dhe boshnjake. Arsimi i detyrueshëm (fillor dhe i mesëm i ulët) është në kompetencë të komunave, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Kosovës. (Islam Krasniqi)

ARSIMI I FEMRËS. Arsimi e femrës është i lidhur me pozitën e saj në shoqëri. Pas Luftës së Dytë Botërore numri i femrave në Kosovë që dinin shkrim-lexim ishte i papërfillshëm. Për arsimimin dhe emancipimin e tyre u miratuan disa ligje dhe vendime të rëndësishme, ndër të cilët edhe ligji për arsimin fillor (1945), me të cilin arsimit shtatëvjeçar bëhej i obligueshëm si për djem, ashtu edhe për vajza. U angazhuan, gjithashtu, edhe organizata dhe institucionet përkatëse shtetërore. Nga nëntori i vitit 1944 u organizua një fushatë e gjerë kundër analfabetizmit, si dhe u mbajtën kurse e shkolla të tjera për arsimin dhe emancipimin e femrës. Angazhimi i përgjithshëm shoqëror bëri që në vitin 1953 në arsimin fillor në Kosovë të përfshihen 83% e vajzave të moshës shkollare. Megjithatë, përqindja e femrave analfabete edhe në vitet në vijim vazhdoi të ishte më e lartë se te meshkujt. Me masivizimin e arsimit fillor të obligueshëm, shtrirjes së rrjetit të arsimit të mesëm, të lartë dhe atij universitar, masivizohet edhe arsimit i vajzave. Në vitin shkollor 2006/07 përfshirja e vajzave në arsimin fillor të detyrueshëm ishte pothuaj e njëjtë me përfshirjen e djemve. Me ritme të shpejta rritet edhe numri i vajzave në shkolla të mesme dhe në studime universitare. Për shkak të ndryshme, të ambientit shoqëror dhe të trashëgimisë patriarkale, ende paraqitet nevoja e aktiviteteve shtesë për arsimimin dhe emancipimin më të avancuar të femrës në Kosovë. (Fahri Buçinca)

ARSIMI I SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI. Është pjesë integrale e historisë së arsimit

të shqiptarëve në tërësi. Një numër i vogël fëmijësh shqiptarë të këtyre trevave u arsimuan në shkolla të pushtuesve të ndryshëm, ndërsa fillet e arsimit shqip lidhen me arsimin fetar qysh në shek. XVII. Numri i shkollave shqipe në territorin e Ulqinit, Tivarit, Tuzit, Plavës dhe Gucisë u rrit gjatë Luftës së Parë Botërore. Si në periudhën 1878-1915, ashtu edhe në periudhën 1918-1941 pushteti i Malit të Zi, përkatësisht i Jugosllavisë nuk lejoi hapjen e shkollave shqipe. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shkolla shqipe u hapën në Ulqin, Krythë, Katërkollë, Sukobinë, Salç, Ostros, Muriq i Poshtëm, Mërkot, Ljare, Gjuraç, Dedaj, Tuz, Arzë, Prifti, Dinoshë, Kojë, Luhar, Triesh, Plavë, Guci, Rozhajë e Dacaj. Në vitet 1945-1984 numri i shkollave fillore prej katër klasash deri në tetë klasa me mësim në gjuhën shqipe në Mal të Zi u rrit dukshëm, ku u mundësua shkollimi i plotë fillor (tetëvjeçar) i nxënësve me mësim në gjuhën shqipe në komunat e Ulqinit, Tivarit, Tuzit, Plavës, Gucisë dhe Rozhajës. Në komunën e Ulqinit u themeluan tri shkolla fillore tetëvjeçare (dy në Ulqin, një në Shtoj), në komunën e Tivarit u themelua një shkollë tetëvjeçare shqipe (në Ostros), në komunën e Podgoricës u themeluan katër shkolla tetëvjeçare (Tuz, Skorraq, Dinoshë dhe Triesh). U themeluan gjithashtu edhe shkollat tetëvjeçare në Guci, përkatësisht në Dacaj (Rozhajë). Një numër i konsiderueshëm nxënësish shqiptarë u arsimuan në shkolla fillore me mësim në gjuhën serbokroate. Në vitin 1965 themelohet gjimnazi i Ulqinit. Në vitin 1971 çelen dy paralele të gjimnazit të Podgoricës në Tuz, ku më 1975 themelohet shkolla e mesme e pavarur. Në vitin 1978 fillon punën një paralele me mësim në gjuhën shqipe në shkollën e mesme në Plavë. Arsimit i lartë me mësim në gjuhën shqipe në Mal të Zi filloi në vitin 2004, me programin studimor për arsimin e mësuesve në gjuhën shqipe, me seli në Podgoricë. (Palokë Berisha)

ARSIMI I TË RRITURVE. Është pjesë integrale e sistemit të arsimit, i cili në Kosovë u intensifikua pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitet e para u zhvillua një veprimtari e gjerë kundër analfabetizmit dhe për emancipimin e popullsisë, sidomos të gruas. Përveç kurseve të ndryshme, arsimit i të rriturve u organizua në shkolla fillore dhe të mesme, në shkolla të amvisërisë, të zejtarisë etj. Ndhimesë të veçantë dhanë

bibliotekat, teatrot, filmi, shtypi, organizatat shoqërore etj. Ndërkohë, për ngritjen kulturore dhe arsimore të të rriturve u themeluan edhe universitetet popullore. Ligji themelor mbi drejtimin e ndërmarrjeve ekonomike-shtetërore nga kolektivat punuese (1950) dhe aktet e tjera ligjore ndikuan në themelimin e institucioneve të tjera për arsimin e të rriturve. Për zhdukjen e analfabetizmit, Këshilli Popullor i Kosovës dhe i Metohisë në vitin 1954 nxori vendimin për hapjen e shkollave fillore dyvjeçare për fëmijët e moshës 12-15 vjeç, të cilët nuk kishin kryer shkollën fillore. Me Ligjin e përgjithshëm mbi shkollat (1958), arsimi i të rriturve në Federatën Jugosllave, pra edhe në Kosovë, merr status më të avancuar dhe konsiderohet pjesë përbërëse e sistemit unik të arsimit. Në vitet '60 të shek. XX kontribut të veçantë në arsimin e të rriturve dhanë qendrat për arsimin profesional të punëtorëve, numri i të cilave në organizatat punuese u rrit dukshëm. Krahas tyre, rol të veçantë në arsimin e të rriturve luajtën edhe universitetet popullore dhe të punëtorëve, shkollat e rregullta, qendrat shkollore, fakultetet, institucionet kulturore, shoqatat profesionale dhe ato shoqërore politike, shtypi etj. Rëndësi të veçantë kulturore-arsimore dhe politike patën edhe shoqëritë kulturore-artistike dhe manifestimet kulturore. Megjithatë, të dhënat statistike të vitit 1971 dëshmojnë se Kosova kishte një popullsi me përqindje të lartë analfabetësh, gjysmën e popullsisë pa shkollë, me shkollë të mesme vetëm 3.14%, me shkollë të lartë vetëm 1.30% të popullsisë. Me Kushtetutën e vitit 1974 dhe statusin e ri të Kosovës në Federatën Jugosllave, si dhe me disa ligje dhe dokumente të tjera, të miratuara nga organet dhe institucionet e saj, arsimi i të rriturve zuri një vend më të avancuar. U bënë edhe projekte e programe për zhdukjen e analfabetizmit, për përmirësimin e strukturës arsimore dhe kualifikuese të popullsisë dhe u ndërmorën edhe aktivitete konkrete në të gjitha shkallët e shkollimit. Megjithatë, rezultatet e dëshiruara munguan. Përqindja e analfabetëve në Kosovë mbeti gjithnjë e lartë. Arsimi i të rriturve u karakterizua nga konceptet tradicionale, nga politizimi, mungesa e infrastrukturës së nevojshme, mungesa e programeve dhe e kuadrit adekuat. Arsimi i të rriturve u anashkalua edhe në Republikën e Kosovës, pas vitit 1999, ndonëse për të u miratua edhe një ligj i veçantë dhe u hartua edhe një strategji me objektiva konkretë (2005). (Demë Hoti)

ARSIMI NË KOSOVË. Përfshin sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës (politikat arsimore dhe struktura e sistemit të arsimit, financimi i arsimit etj.). Pas shkëputjes nga



NJË SHKOLLË FILLORE NË PRISHTINË

sistemi arsimor i Serbisë në vitin shkollor 1990/91 dhe të mbijetesës në rrethana të jashtëzakonshme të pushtimit serb deri në vitin 1999, sistemi i arsimit në Kosovë, krahas riparimit të pasojave të luftës (1998-1999), me ndihmën e institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtare, iu nënshtrua një reformimi të gjithanshëm. Në fillim të viteve 2000 institucionet e Kosovës miratuan disa ligje dhe dokumente të tjera të rëndësishme për arsimin. Në këto dokumente arsimi konsiderohet si “veprimtaria prijëse e zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike”. Synohet të sendërtohet “një shkollë bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare”. Sistemi i arsimit në Republikën e Kosovës mbështetet në disa parime, siç janë: krijimi i kushteve të barabarta për arsimim me qëllim të garantimit të së drejtës themelore për t’u arsimuar; karakteri jopolitik dhe joideologjik i arsimit; decentralizimi dhe autonomia e arsimit; orientimi në karrierë në bazë të prirjeve dhe potencialeve individuale; ndërlidhja e shkollës me jetën; ruajtja e vlerave ekzistuese dhe përcaktimi i vizionit për të ardhmen; gjithëpërfshirja; arsimimi gjatë gjithë jetës etj. Sistemi i arsimit në Kosovë ka një strukturë të konsoliduar. Fillon me sistemin e edukimit parashkollor, i cili ndahet në tri nivele: çerdhja (për fëmijët e moshës 1-2 vjeç); kopshti (3-4 vjeç); dhe klasa parafillore (5 vjeç). Pason arsimi fillor pesëvjeçar (për fëmijët e moshës 6-10 vjeç). Mësimi në shkollën fillore mbahet në pesë gjuhë: shqipe, serbe, boshnjake, turke

dhe kroate. Këtu bëjnë pjesë edhe institucionet arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta (shkollat, paralelet speciale dhe qendrat burimore), mbështetur në filozofinë e arsimit gjithëpërfshirës. Arsimi i mesëm shtrihet nga mosha 11-18 vjeç dhe ka dy shkallë: arsimin e mesëm të ulët (11-14 vjeç) dhe arsimin e mesëm të lartë (15-17/18 vjeç). Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (nëntëvjeçar) është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës shkollore. Arsimi i mesëm i lartë trevjeçar në Kosovë përfshin shkollat e mesme të përgjithshme dhe shkollat e mesme profesionale. Edukimi parashkollor, arsimi fillor dhe arsimi i mesëm përbëjnë sistemin e arsimit parauniversitar. Synohet që mësimi në arsimin e detyrueshëm të organizohet në bazë të kompetencave dhe të aplikohen tekste alternative. Sipas normave ligjore, kuadri arsimor në këto shkallë të shkollimit parauniversitar duhet të jetë me kualifikim universitar, i cili realizohet në fakultete të edukimit dhe në fakultetet e tjera arsimore, pa shpëputje dhe me shpëputje nga puna. Mbi bazën e arsimit parauniversitar ngrihet arsimi i lartë (universitar) në Kosovë, i cili është i organizuar sipas modelit evropian të studimeve, me tri shkallë: shkalla e parë (baçelor) me studime trivjeçare; shkalla e dytë (master) me studime dyvjeçare; dhe shkalla e tretë (doktoratura) me studime trevjeçare. Pjesë integrale e sistemit të arsimit në Kosovë është edhe arsimi i të rriturve.

Arsimi në Kosovë zhvillohet në institucione shoqërore (publike) dhe private (vendore dhe të huaja), duke përfshirë edhe institucionet parashkollore, të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë të licencuara nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë. Arsimi publik është (kryesisht) falas dhe financohet nga buxheti i Kosovës. Në Kosovë ka tri nivele të qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit, duke filluar nga niveli qendror: Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), organi kryesor i planifikimit, i sigurimit të standardeve dhe të cilësisë së arsimit, për të vazhduar me nivelin komunal (drejtoritë komunale të arsimit) dhe atë institucional (organet qeverisëse të shkollës). Krahas modernizimit të sistemit të arsimit sipas standardeve europiane, në Kosovë janë duke u bërë përpjekje edhe për përfarimin e tij me sistemin e arsimit në Shqipëri. (Hajrullah Koliqi)

ARSIMI PARAUNIVERSITAR. Edukimi, arsimi i përgjithshëm dhe aftësimi profesional para studimeve universitare, duke filluar nga arsimi parashkollor (niveli 0) deri te përfundimi i arsimit postsekundar (niveli 4, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED), përfshirë edhe arsimin e të rriturve në këto nivele. Rregullohet me Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011). Sipas këtij Ligji, arsimi parauniversitar në Kosovë organizohet në këto nivele: niveli 0 - arsimi parashkollor, nga lindja deri në moshën 6 vjeç, duke përfshirë edukimin në çerdhe (1-2 vjeç), në kopshte të fëmijëve (3-4 vjeç) dhe në paralele parafillore (5-6 vjeç); niveli 1 - arsimi fillor pesëvjeçar, nga mosha 6-11 vjeç; niveli 2 - arsimi i mesëm i ulët katërvjeçar, nga mosha 12-15 vjeç; niveli 3 - arsimi mesëm i lartë trevjeçar, prej moshës 15-18 vjeç, përfshirë edhe gjimnazet, shkollat e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit; niveli 4 - arsimi postsekundar, përfshirë institucionet e aftësimit profesional 1-2 vjeçar, nga mosha tetëmbëdhjetëvjeçare, specializimi passekundar dhe programe të arsimit gjatë gjithë jetës për të rritur, që mund të ofrohen në nivelin 3 dhe 4 të ISCED-së. Realizohet në institucione publike dhe private, në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve etnike në Kosovë. Bartës dhe menaxhues të arsimit parauniversitar në Kosovë janë Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, komunat dhe organet drejtuese të shkollave përkatëse. (Islam Krasniqi)

ARSIMI PRIVAT. Arsim jopublik i organizuar dhe i financuar nga një person, organizatë apo fondacion privat, ose në partneritet, i licencuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, përkatësisht nga agjenci të specializuara të akreditimit. Arsimi privat në Kosovë filloi pas vitit 1999, kur hapen institucionet e para private të edukimit parashkollor, me nismën dhe mbështetjen e personave të veçantë dhe të organizatave të ndryshme joqeveritare. Ndër institucionet e para të arsimit jopublik në Kosovë janë: Kolgji turk "Mehmet Akif", Sholla e lartë e gazetarisë "Faik Konica" dhe Universiteti Amerikan i Kosovës në Prishtinë. Ndërkohë u themeluan edhe shumë institucione të tjera private, sidomos të arsimit të lartë. Në vitin 2013 kishte 25 institucione, kolegje dhe shkolla të tjera

private të arsimit të lartë. Në Mitrovicën e Veriut punonin tri shkolla private profesionale në gjuhën serbe. Me legjislacionin kosovar për themelimin e institucioneve të arsimit jopublik, paraprakisht duhen plotësuar disa kushte (kritere) që kanë të bëjnë me stafin pedagogjik, hapësirën dhe ambientin për punë, kabinetet dhe pajisjet për studime dhe punë kërkimore-shkencore etj. Arsimi privat në Kosovë është pjesë integrale e sistemit të arsimit kosovar në tërësi. (Islam Krasniqi)

ARSIMI PUBLIK. Arsim dhe edukim që organizohet, financohet dhe mbikëqyret nga shteti, nëpërmjet organeve përkatëse shtetërore. Është dimension i themelor i sistemit të arsimit në tërësi. Përfshin arsimin dhe aftësimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në të gjitha nivelet e arsimit, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit në Arsim (ISCED). Arsimi publik fillor pesëvjeçar (niveli 1) dhe arsimi i mesëm i ulët katërvjeçar (niveli 2) është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës shkollore (6-15 vjeç). Përgjithësisht, arsimi publik në Kosovë është pa pagesë, duke përfshirë këtu edhe tekstet shkollore të arsimit të detyrueshëm. Arsimi publik krijon mundësi për realizimin e të drejtës universale për arsim dhe aftësim profesional, për arsimimin e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe barazi etnike, gjuhësore, gjinore, fetare, orientim seksual, politik, gjendje shëndetësore etj., për arsimim laik dhe gjithëpërfshirës. Themelues, organizues, financues dhe menaxhues i arsimit publik në Kosovë është shteti, përkatësisht Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, komunat dhe institucionet drejtuese të institucioneve arsimore. (Islam Krasniqi)

ARSIMI SHQIP NË DIASPORË. Fillet i ka në ngulimet e para shqiptare jashtë trevave etnike, por në mënyrë institucionale për diasporën shqiptare nga Kosova dhe trevat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, kjo formë e arsimimit nis gjatë viteve 1970, si mësim plotësues (jugosllav). Në vitet '90, me pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë, pavarësohet edhe mësimi shqip në diasporë. Për nxënësit në diasporë, numri i të cilëve asokohe u rrit shumë, për shkak të emigrimit masiv të shqiptarëve nga Kosova e më gjerë, Ministria e Arsimit e Qeverisë së Kosovës në emigrim në vitet 1992-1995 hartoi plan-programe dhe tekste të veçanta. U bënë



MËSIMI PLOTËSUES SHQIP NË DIASPORË

përpjekje për përfshirje sa më të madhe të nxënësve në shkolla shqipe dhe në mësimin plotësues, sidomos në disa vende europiane. Së fundi është shtuar angazhimi për bashkëpunim midis autoriteteve shtetërore të Shqipërisë dhe të Kosovës, për përafrimin dhe njëjtësimin e politikave të mësimin plotësues shqip në diasporë, me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të origjinës, të integritetit më të lehtë në shoqërinë vendore dhe të riintegritetit më të lehtë në vendin e origjinës. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Kosovës ka botuar disa tekste mësimore për fëmijët në diasporë. Në vitin 2007 ka hartuar edhe një kurikulë të veçantë. Prej vitit 2005 MASHT-i e Kosovës dhe prej 2007 bashkëngjitur edhe nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Shqipërisë, organizojnë takime të rregullta vjetore të mësuesve të diasporës në formën e një seminari didaktik profesional, ku marrin pjesë rreth 150 mësues shqiptarë nga vende e rajone të ndryshme të Europës. Me gjithë vështirësitë e ndryshme, vlerësohet se në mësimin plotësues në diasporë janë përfshirë rreth 30,000 nxënës shqiptarë të moshës së arsimit të detyrueshëm. (Nuhi Gashi)

ARSIMI SHQIP NË MAQEDONI. Përpjekjet për arsimin shqip në trevat shqiptare të Maqedonisë filluan gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Megjithatë, kthesa e parë e rëndësishme ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur në Maqedoninë Perëndimore (Ohër, Strugë, Dibër, Kërçovë, Gostivar, Tetovë) u hapën shumë shkolla fillore dhe disa shkolla të mesme. Pas Luftës së Dytë Botërore, arsimi shqip në Maqedoni u zhvillua në kuadër të sistemit të arsimit të ish-Jugosllavisë, përkatësisht të Maqedonisë. Ndonëse me

shumë vështirësi politike, ekonomike, mungesë kuadri e teksteve mësimore etj., arsimit shqip u zhvillua në të gjitha shkallët e shkollimit. Institucionet shtetërore dhe politike të Maqedonisë deri së voni i krijuan pengesa të vazhdueshme shkollës shqipe në këtë vend. Arsimit fillor shqip, fillimisht katërvjeçar, pastaj edhe shtatë e tetëvjeçar, u hap në të gjitha trevat shqiptare në Maqedoni, por shumë më ngadalë se arsimit në gjuhën maqedone. Problemi i veçantë ishte vijimi i arsimit fillor nga vajzat shqiptare. Ndërkaq, arsimit i mesëm u zhvillua edhe më ngadalë. Filloi, kryesisht, me hapjen e gjimnazeve në Strugë, Dibër, Kërçovë, Gostivar, Tetovë, Shkup, Kumanovë dhe të Shkollës Normale në Shkup. Filloi të masivizohet nga viti 1957, me organizimin e tij edhe në shkollat tjetra të mesme profesionale, siç ishin shkollat e mesme të mjekësisë, ekonomike, bujqësore, tregtare, e muzikës, e artit etj. U hapën shkollat tjetra të mesme profesionale me drejtime të ndryshme, me programe tre e katërvjeçare. Mësimi organizohej në gjuhën shqipe (për nxënësit shqiptarë) dhe në gjuhën maqedonase (për nxënësit maqedonas). Në vitin 1984 institucionet shtetërore morën nismën për formimin e paraleleve të përziera me nxënësit shqiptarë e maqedonas, me mësim në gjuhën maqedone, gjë që u kundërshtua nga shqiptarët. Në vitin 2008 arsimit i mesëm në Maqedoni bëhet i detyrueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e moshës shkollore.

Ndërkaq, arsimit i lartë në Maqedoni filloi me themelimin e Fakultetit Filozofik (1946), përkatësisht me Universitetin e Shkupit (1949), me mësim në gjuhën maqedonase, ku studionin edhe studentët shqiptarë. Arsimit i lartë shqip, pastaj, filloi me themelimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike dhe të degës së albanologjisë në kuadër të Fakultetit Filozofik në Shkup. Shkolla e Lartë Pedagogjike u themelua në vitin 1947, ndërsa grupi i gjuhës shqipe në kuadër të saj u themelua në vitin shkollor 1951/52 për përgatitjen e kuadrit arsimor me kualifikim të lartë. Dega e albanologjisë fillimisht veprimi si lektorat në Fakultetin Filozofik të Shkupit, ndërsa nga viti akademik 1959/60 ngrihet në seminar të gjuhës shqipe, pastaj në vitin akademik 1971/72 themelohet grupi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, i cili në vitin 1974 shndërrohet në katedër të gjuhës dhe letërsisë shqipe, si pjesë e Fakultetit të Filologjisë. Në vitin 1995 në kuadër të Universitetit të

Shkupit themelohet Fakulteti Pedagogjik, me dy grupe studimore: mësim klasor dhe edukim parashkollor, me mësim në tri gjuhë: maqedone, shqipe dhe turke. Në vitin 1994 u themelua Universiteti i Tetovës, veprimtaria e të cilit në vitin 2004 u legalizua dhe mori emrin Universiteti Shtetëror i Tetovës. Në vitin 2001 në Tetovë u themelua edhe Universiteti i Europës Juglindore. (Xheladin Murati)

ARSIMI SHQIP NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË.

Arsimit shqip në këtë trevë filloi pas Luftës së Dytë Botërore. Shkollat e para fillore shqipe në komunën e Preshevës u hapën në fillim të vitit 1945, në fshatin Raincë, në Preshevë, në Miratoc dhe në Rahovicë, ndërsa në shator të vitit 1945 edhe në fshatrat Corroticë, Tërrnavë, Norçë, Zhunicë, Bukuroc dhe Geraj. Në vitin shkollor 1948/49 në shkollën e Preshevës, për herë parë, fillon klasa e pestë, e cila në vitin shkollor 1953/54 u shndërrua në shkollë të plotë fillore. Njëkohësisht, në shkollat të plota fillore do të ngrihen edhe shkollat në Miratoc, Raincë dhe Caravajkë, pastaj në Rahovicë në vitin shkollor 1961/62, në Strezovcë (1965/66) dhe në Leran (1968/69). Në fillim të vitit 1945 shkollat katërvjeçare me mësim në gjuhën shqipe u hapën edhe në komunën e Bujanocit, së pari në Tërnoc, Nasalcë e Lluçan. Shkollat fillore e Tërrnocit në vitin shkollor 1950/51 filloi edhe me klasën e pestë. Paralelet të ndara kishin shkollat në Bujanoc, Lluçan, Nasalcë, Turi, Konçul, Dobrosin dhe Tërnoc i Vogël. Gjatë viteve në vazhdim u bënë edhe riorganizime të tjera të këtyre dhe shkollave të tjera. Ndërkaq, arsimit fillor në gjuhën shqipe në komunën e Medvegjës filloi në vitin shkollor 1951/52, në fshatin Tupallë, si paralelet e shkollës tetëvjeçare serbe e Medvegjës. U pavarësua në vitin shkollor 1969/70. Kësaj shkolle tetëvjeçare iu bashkëngjitën edhe shkollat katër klasash në Gjylekreshtë dhe Kapit. Në shkollën fillore në Banjë të Sijarinës mësimi shqip ka filluar të zhvillohet në vitin shkollor 1967/68. Ndërkaq, arsimit i mesëm në këto treva filloi në vitin 1947, me themelimin e shkollës së nxënësve në ekonomi. Në vitin 1961 në Preshevë hapen edhe paralelet e para të gjimnazit të Vranjës, i cili reformohet disa herë dhe transferohet në Bujanoc. Në vitin shkollor 1978/79 në Medvegjë u hapën dy paralelet të ndara në gjuhën shqipe të shkollës së mesme, të cilat u ndërpre në vitin shkollor 1987/88. Së fundi në komunën

e Preshevës vepronë gjashtë shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe, një me mësim në gjuhën shqipe dhe serbe dhe dy shkolla të mesme; në komunën e Bujanocit vepronë pesë shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe dhe një shkollë e mesme, kurse në Medvegjë punon vetëm një shkollë fillore shqipe. Arsimi në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ishte pjesë integrale e sistemit të arsimit në Serbi. Arsimi shqip në këto treva pati dhe ka vështirësi të ndryshme të natyrës ekonomike dhe politike. Mësimdhënësit dhe veprimtarët e tjerë të arsimit shqip ishin vazhdimisht nën mbikëqyrjen dhe presionin e pushtetit. (Gafur Hyseni)

ARSIMI SHQIP NË VITET 1941-1944. Qeveria e Tiranës, në Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste, në vitin 1941, në “tokat e lirueme”, ku përfshihej pjesa më e madhe e Kosovës dhe e trojeve të tjera shqiptare, krahas ngritjes së administratës në gjuhën shqipe, u angazhua edhe për ngritjen e një sistemi arsimor unik kombëtar. Ajo formoi inspektoratet e arsimit, drejtoritë didaktike, miratoi dekrete, vendime, qarkore etj., përkritazi me arsimin shqip në Kosovë dhe në trevat shqiptare në Maqedoni dhe në Malin e Zi. Ministria e Arsimit organizoi kurse për mësimin e gjuhës shqipe, solli tekste shkollore, solli mësues nga Shqipëria për hapjen e shkollave dhe organizimin e arsimit shqip në këto treva. Gjatë vitit të parë shkollor 1941/42 u hapën 174 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme dhe profesionale, ndërsa një vit më pas numri i tyre rritet, ndonëse në kushte lufte. Në vitin shkollor 1943/44 në Kosovë dhe në trevat shqiptare në Maqedoni punuan 11 shkolla të mesme dhe profesionale shqipe, me 848 nxënës (721 meshkuj dhe 127 femra) me 81 mësimdhënëse, shumica nga Shqipëria. Shkollat shqipe u themeluan dhe vepruan edhe në Qarkun e Mitrovicës, nën administrimin gjerman. (Ali Lllunji)

ARSIQ-BASARA Svetomir (1928-). Skulptor. Lindi në fshatin Cevc të Shtërpçës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë, ndërsa studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1958). Ligjëroi për skulpturën në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më pas në Akademinë e Arteve deri në pensionim më 1995. Në vitin 1982 është pranuar anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të



SVETOMIR
ARSIQ-BASARA

Kosovës, të cilën e braktisi në vitin 1990, për shkaqe politike, duke u radhitur në krah të politikës antishqiptare të Millosheviqit. Veprat e tij në skulpturë janë të shkëputura nga jeta, legjenda, religjioni. Në fazat e mëvonshme fi-

lloi të trajtojë një cikël monumental, skulptura të dimensioneve të mëdha, i inspiruar nga historia dhe religjioni. Ekspozitat personale më të rëndësishme janë: Salla e Universitetit të Punëtorëve, Prishtinë (1971), foajeu i Teatrit Krahinor, Prishtinë (1970), Galeria e Arteve në Prishtinë (1979) etj. Është autor i disa përmendoreve dhe skulpturat në hapësira publike, si Përmendorja e Boros dhe Ramizit në Landovicë (1963) dhe përmendorja e partizanëve të Sharrit në Brezovicë (1964) etj. Është fitues i disa çmimeve për skulpturë. (Agim Rudi)

ARSLLANI Ismail (1947-). Gazetar. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa degën e artit figurativ në Akademinë Pedagogjike të Shkupit. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit. Punën në gazetari e filloi në vitin 1973, fillimisht si redaktor në Qendrën për informim dhe veprimtari botuese “Pollog” në Tetovë, kurse nga viti 1976 e deri më 2001 ishte korrespondent i gazetës “Rilindja”, përkatësisht “Bujku”, të Prishtinës. Gjatë viteve 1992-1993 bashkëpunoi me Radiotelevizionin e Shqipërisë, ndërsa në vitet 2001-2003 ishte korrespondent nga Tetova i gazetës “Koha ditore”. Nga viti 2003 ishte koordinator i zyrës së korrespondentëve të gazetës “Flaka e vëllazërimit” nga Tetova, kurse në vitet 2005 redaktor i gazetës “Lajm”, edicioni i Shkupit. Është autor i librave publicistikë “Distinktivi tetovar” dhe “Përthyerjet politike (në transicion)”. (Zenun Çelaj)

ARSLLANI Melik (1966-). Pikturor. Lindi në Dobërdoll të Gostivarit. Shkollimin e kreu në Gostivar, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është mësimdhënëse në Fakultetin e Arteve të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Frymëzimi i tij figurativ rrjedh nga motivet tradicionale kombëtare që janë pjesë e

enterierit dhe eksterierit. Është pjesëmarrës në disa ekspozita kolektive si dhe hapi ekspozita personale në Gostivar, Tetovë, Shkup, Tiranë, Pragë, Maribor, Grac të Austrisë dhe në Zyrih. Aktualisht është pedagog në Universitetin Shtetëror të Tetovës. (Jëlldeze Asani)

ARTANA. Shih: **NOVOBËRDA.**

ARTET PAMORE NË KOSOVË. Vlerat e kulturës së lashtë, gjetjet arkeologjike të periudhave të ndryshme historike, pasuria e folklorit, e etnografisë dhe të dhënat e tjera që ndeshen në



GALERIA E ARTEVE E KOSOVËS

Kosovë dëshmojnë për një traditë të hershme të arteve pamore në këtë hapësirë. Zbukurimet e qeramikave ilire dhe gjetjet në objekte të hershme a të mëvonshme të kultit, megjithatë nuk dokumentohen (ose pasqyrohen rrallë) me autoritete të veçanta krijuese. Duhet pritur vitet '30 të shek. XX, kur gjakovari Abdurrahim Buza përfundoi studimet në Akademinë e Firences (1933) bashkë me Qamil Grezdën, si dhe Shahin Kryeziun, i cili i nisi ato në Torino dhe i vazhdoi në Firence, por nuk i përfundoi, për të gjetur emrat e parë të artistëve pamorë nga këto anë. Edhe pse kanë qëndruar një kohë në Kosovë, Buza e Grezda u vendosën në Shqipëri. Prandaj nismat e vërteta të artit pamor duhen kërkuar te themelimi i institucioneve të para arsimore në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Data të rëndësishme të këtyre zhvillimeve janë themelimi i Shkollës së Mesme të Arteve Ap-

likative në Pejë (1949) dhe hapja e grupit të artit figurativ në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1962). Pas kryerjes së këtyre shkollave, shumë entuziastë të rinj vazhduan studimet në qendra të ndryshme jashtë Kosove dhe u kthyen tashmë si artistë të dëshmuar. Me ardhjen e tyre u krijuan kushtet për ngritjen e kuadrit artistik të kualifikuar dhe u hap perspektiva e inkuadrimin në rrjedhat e artit bashkëkohor në përgjithësi. Nga Shkolla e Mesme e Artit në Pejë dolën gjeneratat e para: Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Rexhep Ferri, Xhevdet Xhafa, Gjelosh Gjokaj, Agim Çavdarbasha, si dhe Nusret Salihmixhiqi, Shyqri Niman, Nebih Muriqi, Fatmir Krypa, Nuredin Loxha, Agush Beqiri etj., të cilët pastaj vazhduan studimet e rregullta dhe ato pasuniversitare në qendrat ish-jugosllave, për t'u rikthyer në Kosovë si artistë piktorë, skulptorë, grafikë, disenjatorë e artistë të tjerë aplikativë, skenografë, kostumografë, interieristë etj. Pothuaj të gjithë këta krijues, si dhe të tjerët që dolën më vonë nga këto shkolla, bënë hapat e parë si pedagogë në Shkollën e Lartë Pedagogjike, që do të shndërrohet në Akademinë e Arteve (1973) apo më vonë Fakulteti i Arteve, në gjirin e Universitetit të Prishtinës, siç paraqitet sot, duke formuar gjenerata të tëra piktorësh, skulptorësh, grafikësh si dhe artistësh të fushave të ndryshme të arteve të aplikuara, të cilët sollën një frymë të re në artin dhe në kulturën e këtyre anëve. Që në vitin 1953 ishte inicuar dhe aktiviteti ekspozues i krijuesve figurativë. Atë vit në Gjakovë u hapën ekspozitat e Shahin Kryeziut dhe Muslim Mulliqit. Më 1957 u themelua Klubi i Artistëve Figurativë të Kosovës, të cilët përshpejtuan afirmimin e vlerave të mirëfillta figurative. Veprimtaria e Klubit u kurorëzua me shndërrimin në Shoqatë të Artistëve Figurativë të Kosovës më 1965, e cila do të iniciojë shumë aktivitete të rëndësishme të prezentimit të artistëve kosovarë, ekspozita vjetore, bienale, koloni artistike etj. Një ngjarje tjetër me rëndësi, që do të ndikojë në zhvillimin e arteve pamore është themelimi i galerisë së parë artistike, e cila do të marrë udhë në Prishtinë më 1979 me ekspozitën e veprave nga fondi artistik i trashëguar nga Bashkësia e atëherëshme Krahinore e Kulturës, në fillim në mjediset e qendrës tregtare në kompleksin e Pallatit të Rinisë në Prishtinë, më vonë në objektin e ish-Muzeut të Revolucionit, ku vepron dhe sot si Galeri Kombëtare e Kosovës. Në vitet e tetëdhjeta, sidomos pas trazirave të vitit 1981, një

pjesë e krijuesve pamorë të Kosovës, të joshur edhe nga klima artistike e qendrave të mëdha të artit, do të migrojnë në vende të ndryshme, kryesisht europiane. Disa prej tyre do të mbeten edhe më tej atje, duke zhvilluar një aktivitet të dendur, si: Daut Berisha dhe Valdet Kuçi (Francë), Gjelosh Gjokaj, Bahri Drançolli dhe Ymer Shaqiri (Gjermani), Mikel Gjokaj (Itali), Zyhdi Çakolli (Poloni), Shyqri Gjurkaj (Suedi), deri te më të rinjtë si Gani Llallosi (Slloveni), Sislej Xhafa (SHBA), Jakup Ferri (Holandë) e shumë të tjerë. Është e nevojshme të përmenden lëvizjet alternative të viteve '90, të imponuara nga represioni i regjimi serb. Artistët shqiptarë, që u larguan me forcë nga institucionet arsimore dhe kulturore, u desh të ekspozonin në hapësira të improvizuara, në restorante apo në galeri me iniciativa private ("Dodona" në Prishtinë, "Europa" në Pejë, "Rada" në Prizren etj.) Në këto galeri prezantoheshin edhe krijues të rinj, të cilët jo vetëm që sollën freski me instalacione rudimentare, por dëshmuar se edhe në ato kushte kishin arritur të ecnin në hap me kohën dhe me lëvizjet e rëndësishme në art. Në kuptimin tematik vërehet pluralizmi i shprehjeve figurative të pas Luftës së Dytë Botërore, nga të cilat më zotëruese janë: realizmi, impresionizmi, intimizmi, fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi, arti abstrakt, surealizmi etj. Ky i fundit, në qendrat e mëdha do të lindë enformelin si drejtim, i cili në Kosovë paraqet inkuadrimin e parë të pavarur në rrjedhat e lëvizjeve bashkëkohore të arteve pamore. Janë këto lëvizje që te ne sollën vepra të një sensibiliteti modern, të botëkuptimeve bashkëkohore të një periudhe të ndërlikuar. Lëvizjet e dhjetëvjeçarit të shtatë, siç janë: neofiguracioni, pop-arti, piktura e kombinuar si dhe reflektset e kohëve më të reja të artit transavangard mund të vërehen edhe te disa krijues kosovarë. Por ajo që është parësore për krijuesit pamorë kosovarë është motivi autokton ndaj rrymave aktuale, brenda dhe jashtë vendit. Veçanërisht në këtë mes shquhen artistët e rinj, që inkuadrohen në lëvizjet dhe rrymat më bashkëkohore të artit konceptual, të njohur me instalacione, performanca, videoprojekte dhe forma të ndryshme të shprehjeve bashkëkohore, që i bënë ata të pushtojnë sot metropolet europiane e botërore të artit dhe t'i sjellin artit e kulturës sonë reputacionin e një fidanishteje të pashtershme artistësh e talentesh që kanë ç't'i thonë botës së arteve pamore. (Hivzi Muharemi)

ARTI POPULLOR. Objekte të mjeshtresë krijuese për përdorim të përditshëm, që prodhohen nga krijues anonimë, duke i zbuluar ato sipas mendësisë popullore. Tradita e artit popullor është zhvilluar që nga periudhat e hershme dhe vazhdon edhe sot. Tradicionalisht objektet janë punuar në dru, në hekur, bakër, gur, në lesh, në tekstil etj.

Punimet artistike në metale aplikoheshin kryesisht në objekte shtëpiake, armë, stoli dhe enë bakri e mesingu. Trokitëset dhe rezat e portave punoheshin prej hekuri, me teknikën e rrahjes. Trokitëset janë stolitur me figura florale, me figurat e kokës dhe të dorës së njeriut etj. Ndërkaq, në reza dhe në mashat e vatrës në shtëpinë e zjarrit paraqiten figura të ndryshme, në mes të cilave edhe figura e gjarprit. Armët dhe stolitë punoheshin me teknikat e rrahjes, të derdhjes, të savatit, të filigranit dhe granulimit, të cilat kanë qenë të njohura qysh në kohët e hershme. Veçohet teknika e filigranit, e disajnuar me fije të holla dhe të dredhura të argjendit. Punime artistike në objekte prej bakri aplikoheshin në sini, tepsi, legenë me ibrikë, enët e ndryshme, mbajtës filxhanash, xhezeve, tabakë, mangall, tangarë, kazanë, kusi, gjyma etj. Këto objekte punoheshin me teknikën e rrahjes dhe të gravurës e savatit. Punime artistike në dru aplikoheshin në objektet e enterierit të shtëpive qytetare dhe fshatare: tavane, porta, dollapë dhe shtylla. Në shtëpitë më karakteristike qytetare mjeshtrit ishin kryesisht dibranë, të cilët punonin me teknikat e drugdhendjes së cekët dhe të thellë. Ndërkaq, në fshatra nga druri janë punuar pipa, kërraba, instrumente muzikore, arka të nuseve, djepa, magje buke, parmenda dhe zgjedha. Rajoni i Rugovës përmendet për punimin e enëve për ruajtjen e bulmetit; rajoni i Hasit të Prizrenit për punimin e djepave; Gjakova për punimin e arkave të nuseve etj. Punime artistike në gur aplikoheshin në qoshtet e mureve dhe në portat e kullave, në oxhaqe, në odën e miqve dhe në odën e zjarrit etj. Zbukuroheshin portat e kullave, kornizat e të cilave janë të gdhendura me një plastikë të pasur ornamentale, të punuar me teknikat e gdhendjes së cekët dhe të thellë. Punimet artistike në tekstil aplikoheshin në veshje popullore, në shtroja dhe qëndisje tradicionale. Veshjet popullore të Kosovës janë të pasura si për nga tipologjia, ashtu edhe për nga ornamentet. Shtrojat janë punuar me teknikat e endjes, të qepjes, të thurjes dhe

të qëndisjes. Qilimat, sixhadetë dhe strukat prej leshi endeshin në tërë Kosovën, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, në qendrat zejtare siç ishin Peja dhe Prizreni, pastaj në rajonin e Rugovës, të Drenicës, të Lumës, të Opojës dhe të Gorës. Peja dhe Prizreni ishin të njohur edhe për endjen dhe qëndisjen e pëlhurave të mëndafshhta dhe të pambukta. Punoreshin çarçafët, havllitë, mbulesat e djepit, maramat për duar dhe fytyrë, maramat e fejesës, maramat zbukurorese të dhomave etj. Në objektet e artit popullor paraqiten motivet zoomorfe, gjeometrike, florale, fetare dhe antropomorfe. Në ndonjërin gjejmë motive kozmike (motivët e diellit, të yllit me gjashtë ose tetë cepa, të hënës, gjysmëhënës etj.). Gjithashtu paraqiten motive të stilizuara të kambanës dhe të patkoit, si shenjë e mikpritjes, në tasat, në filxhanët dhe ibrikun e kafesë.

Objektet e artit popullor kosovar janë një trashëgimi e çmuar etnografike, ekzemplarët e të cilëve hyjnë në radhën e rariteteve të çmuara, të vlerësuara nga profesionistët vendorë dhe të huajt. (Shpresa Siqeca)

ARTI SHKËMBOR PARAHISTORIK I VLASHNJËS. Pikturim shkëmbor parahistorik. Përbëhet nga grupimi skematik i 17 spiraleve dhe drerit, të vendosur në hijeroren e hapur.



ARTI SHKËMBOR I VLASHNJËS

Pikturimi është bërë me ngjyrë të kuqe, mbi sfond të bardhë. Kryesisht është i mbuluar me kalcit. U zbulua te “Mrizi i Kobajës” te

Vlashnja (Prizren, 2005), në anën e djathtë të Lumëbardhit dhe derdhjes së tij në Drinin e Bardhë. Spiralet janë pikturuar në dy hapësira të tavanit të hijerores (tavani I, II) dhe në dy horizonte të pikturimit mural (horizonti I, II.). Spiralet në tavan lidhen me sferat qiellore, ndërsa ato murale me botën tokësore e të nëndheshme, të sforcuar me prezencën e drerit në horizontin I, i cili iu paraprin vargut të spiraleve. Simbolet lidhen me botëkuptimet mbi ciklin e jetës, ndërsa grupimi i spiraleve me kahe të ndryshme në tavan mund të jetë dhe kalendari i kohës. Hapësira e “Mrizit të Kobajës” ishte një labirint jetësor, hapësirë iniciacioni, ku të rinjtë ballafaqoheshin me sprovat e jetës e të vdekjes, për të kaluar në moshën e pjekurisë dhe për t’u pranuar anëtarë të plotë të bashkësisë fisnore. Arti shkëmbor parahistorik njihej më parë në Ballkanin Perëndimor vetëm nga gjetjet në Tren (Shqipëri) dhe në Lipci (Mali i Zi). Por, arti shkëmbor i Vlashnjës del si një dukuri unike për nga pikturimi dhe përmbajtja e saj e veçantë. Ky shpreh zhvillimin e botës shpirtërore të banorëve parahistorikë dhe në të njëjtën kohë paralajmëron gjetje të tjera të këtij lloji në Kosovë dhe më gjerë. (Edi Shukriu)

ARUMANISHTJA. Një nga katër dialektet kryesore të rumanishtes dhe gjuhë e popullatës arumune që jeton në Ballkan: Greqi (Thesali e Epir), në Shqipëri të Jugut, në Maqedoni dhe në Bullgari. Ka studiues që e trajtojnë gjuhë më vete. Njihen edhe me emrat vllëh, cincar, kucovllah, në Shqipëri çoban, rëmër. Përmenden qysh nga mesi i shek. VIII në Halkidiki, kurse në shek. X në Prespë. Shkrimi i parë arumanisht është i vitit 1731 i gjetur në kishën e Shën Mërisë në Shqipëri të Jugut në një mbishkrim latinisht, greqisht dhe shqip me alfabet arab. Në shek. XVIII ka pasur veprimtari kulturore të arumunëve rreth Voskopojës dhe Akademisë së saj. Janë të njohur fjalori katërgjuhësh i Danilit nga Voskopoja dhe ai tregjuhësh i Kavaliotit, ndërsa në shek. XIX është hartuar gramatika e parë e arumanishtes me alfabet latin. Është gjuhë pa status të gjuhës zyrtare, kombëtare e shtetërore. (Drita Tërshani)

ARVANITIKA. Shih: **ARBËRISHTJA E GREQISË.**

ARRA. (*Juglans regia* L.) Dru i familjes së arroveve (*Juglandaceae*) i lartë 25-30 m. Është bimë

spontane nga Europa Juglindore deri në Kinë. Supozohet se në viset tona është auto-ktone, ngase gjendet në disa pyje. Në Europë është mjaft e përhapur, si bimë e dobishme. Zakonisht ka kurorë të gjerë, lëvorja e trungjeve të reja është e lëmuar, te të vjetrat e pëlcitur për së gjati. Gjethet rënëse të përbëra teke pendore me nga 5-8 gjethëza, me erë karakteristike. Gjethet përmbajnë alkaloidin juglandin, vajra eterike dhe vitamina. Lulet njëseksore të blerta me periant të thjeshtë. Ato mashkulloret janë lulesa levare (rezhde) të gjata 6-19 cm dhe çelin në prill, pak para gjethësimit. Lulet femërore shfaqen të vetmuara ose 2-5 së bashku, në bisqe të reja. Fryti bërthokël me një farë të madhe qendrore me dy thelpinj, i veshur në pjesën e jashtme me një shtresë mishtore të gjelbër e brenda me endokarp drunor. Fryti është shumë i përdorshëm, ngase përmban vlera të veçanta ushqimore. Thelpinjët e vrimëzuar përmbajnë yndyrë, proteinë, karbohidrate, kripëra minerale dhe vitamina C, B₁, B₂, PP dhe vajra eterike. Arra jeton 200-400 vjet. I pëlqejnë tokat e thella dhe të freskëta të zonës së dushkut. Ndeshet kudo nëpër Kosovë e në kulturë rriten kultivarë të ndryshëm, kurse bimët e reja nëpër pyje janë shpërndarë nga shpendët. Druri i arrës llogaritet ndër drurët më të çmueshëm që përdoret për orendi të ndryshme të cilësisë së lartë. (Feriz Krasniqi)

ARRIBANTIONI. Qytet antik dardan. Përmendet në veprën "Geographia" të Ptolemeut, nga Aleksandria e Egjiptit (90-168). Ilirologu gjerman H. Krahe (1898-1965) e nxjerr etimologjinë e emrit "Arribantium" me origjinë ilire, duke u mbështetur në rrënjën "bant". Vendndodhja e qytetit nuk dihet. Duke bashkërenditur vlerat e gjatësisë dhe të gjerësisë gjeografike të Ptolemeut me hartat moderne, mendohet se Arribantioni mund të jetë ndërmjet Ferizajt dhe Gjilanit, afër Binçës së Vitisë. (Arianit Buçinca)

ASANI Bexhet (1957-). Mbledhës dhe studiues i folklorit, mësimdhënës, shkrimtar. Lindi në fshatin Zagraçan, (Strugë, Maqedoni). Shkollën filllore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Strugë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe dhe studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Prishtinës. Mbrojti temën e disertacionit të doktoratës nga fusha e letërsisë popullore në Universitetin e Shkupit

(2007). U mor me gazetari dhe mësimdhënie. Në fushën e studimeve folklorike botoi monografite: "Lirika popullore shqiptare në Maqedoni", "Këngët popullore rituale toske të trevës së Strugës", pastaj përmbledhjet e këngëve popullore "Ç'u këput një degë qarri" (1996), "Zura trëndafil me vesë" (2003) etj. Botoi edhe vepra letrare: "Nuse përtej detit" (tregime), "Baladë për numrin" (poezi) etj. (Leontina Musa)

ASDRENI Aleks Stavre Drenova (1872-1947). Poet, veprimtar kulturor e politik në koloninë shqiptare të Bukureshtit, autor i Himnit Kombëtar. Lindi në Drenovë të Korçës.



ALEKS STAVRE
DRENOVA-ASDRENI

I mbetur herët jetim, ndërpreu shkollimin në gjimnazin grek të Korçës për të mërguar në Rumani më 1885, ku do të qëndrojë gjatë gjithë jetës, me përjashitim të udhëtimit të shkurtra në atdhe. Njohtësia me Nikolla Naçon e përfshiu në lëvizjen kulturore e atdhetare të Rilindjes dhe më 1892 u bë anëtar i shoqërisë "Drita" dhe redaktor i gazetës "Albanezul" (Shqipetari). Autodidakt e i zellshëm, Asdreni vijoi formimin falë shkollës informale rumanisht-shqip për të rinjtë e varfër të N. Naçon (1892). Ndoqi ligjëratat dhe u diplomua në Akademinë tregtare për nëpunës administrate. Botoi poezitë e para, me frymë patriotike, më 1901 te "Albania" e Konicës, me pseudonimin "Asdren". Bashkëthemelues i "Qarkut të studentëve shqiptarë" u bë promotor i riorganizimit të tij në shoqërinë "Shpresa", u zgjodh nënkryetar dhe nisi më 1903 botimin e gazetës "La Renaissance albanaise" (Përlindja shqiptare). Botoi përmbledhjen poetike "Reze djelli" (1904), e përshëndetur ngrohtë nga Konica, Çajupi, Skiroi etj. dhe "Ëndra e lotë" (1912). Në tetor të vitit 1912 Asdreni, tashmë personalitet i shquar i kolonisë shqiptare të Bukureshtit u bë bashkorganizator me Luigj Gurakuqin i "mbledhjes historike të Bukureshtit" për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. I zgjedhur sekretar dhe delegat i kolonisë në mbështetje të Vidit më 1914, më pas sekretar i parë i konsullatës shqiptare në Rumani, nga 1922-1934 me shkëputje, mik dhe mbështetës i Lasgush Poradecit e të rinjve të tjerë, u dekorua më

1928 me gradën “Oficer i Skënderbeut”. Botoi përmbledhjen më të mirë të tij “Psallme murgu” (1930). Vizitoi për herë të fundit atdheun në vitin jubilar 1937. Pritet si poet kombëtar në Shkodër, nderohet nga Gj. Fishta e shoqërohet kudo nga Lasgush Poradeci. Nisi përgatitjen, por e la të pambyllur përmbledhjen e fundit “Kambanat e Krujës”. Pas pushtimit italian u kthye përfundimisht në Bukuresht. E shtrirë në katër dekada, krijimtaria poetike e Asdrenit shfaq pamje e tipare të ndryshme, nga ato romantike të Rilindjes deri te ato të modernitetit. Fryma naimjane e “Reze djelli”, përmbledhje e ngarkuar me retorizëm romantik, i lë vendin sprovës parnasiane të kultit të formës e stolisjes te “Ëndra e lotë” dhe kulmon me pjekurinë e kërkimin formal simbolist, finesën e detajit, thellësinë epifanike të fjalës, por edhe me shprehinë ekspresioniste te “Psallme murgu”. Ndërsa vepra postume “Kambana e Krujës”, botuar më 1971 në Prishtinë, mbledh poezi në dorëshkrim ose të botuara në periodikë të shumtë, pa përfutur ende një identitet më vete. Në historinë e letërsisë shqipe Asdreni mund të cilësohet i pari për një poetikë kompozicionale ciklike, tipar poetik simbolist, në të cilin njësia ciklike përkon me njësinë tematike. Asdreni sjell në lirikën shqipe pavarësimin e natyroses si njësi lirike më vete, eksperimentet metrike dhe sidomos vargun e lirë. (Persida Asllani)

ASISTENCA FINANCIARE. Ndhimja që u jepet personave në nevojë nga ana e qeverisë ose institucioneve joqeveritare. Përmes kësaj ndihme organizatat qeveritare dhe joqeveritare kujdesen për grupet e marginalizuara në shoqëri. Një ndihmë e këtillë mund t’u jepet edhe të rinjve, zakonisht studentëve, për t’i mbuluar shpenzimet e shkollimit. Nocioni i asistencës financiare lidhet edhe me subvencionimin e veprimtarive të ndryshme në shoqëri, për shembull bujqësisë. Përmes programeve të ndryshme të asistencës, bujqit subvencionohen në mënyra të ndryshme, përmes pagesave të drejtpërdrejta, kredive me interes zero ose interes të vogël, pastaj përmes garantimit të kredive dhe ngjashëm. Qeveria e Kosovës e ka rritur në vazhdimësi buxhetin për mbështetjen e bujqve, përfshirë këtu edhe asistencën e drejtpërdrejtë financiare, me qëllim të përmirësimit të prodhimeve bujqësore të vendit. (Venera Demukaj)

ASISTENCA NDËRKOMBËTARE FINANCIARE. Ndhimja financiare e dhënë për vendet në zhvillim nga agjencitë zhvillimore të qeverive të huaja, nga bankat zhvillimore shumëpalëshe ose nga organizatat financiare ndërkombëtare. Kjo lloj ndihme jepet kryesisht në formë të granteve apo kredive me kushte të volitshme (kredi të buta) dhe jepet me qëllim të rindërtimit, ristrukturimit dhe stabilizimit social dhe ekonomik të vendeve në zhvillim. Është pjesë përbërëse e një nocioni më të gjerë, e quajtur ndihma e jashtme, e cila, përveç asistencës financiare, përfshin edhe asistencën humanitare, ekonomike, teknike dhe ushtarake. Në Kosovën e pasluftës, në vazhdimësi, më shumë së gjysma e asistencës së jashtme ka ardhur si asistencë teknike përmes projekteve të përgatitura nga donatorët dhe në formë të granteve. Nga të dhënat e raportuara nga Ministria për Integrime Europiane del se për periudhën 2008-2010 në Kosovë janë distribuuar gjithsej 572 milionë euro si ndihmë e jashtme, prej së cilës rreth 95% në formë të granteve, ndërsa pjesa tjetër në formë të kredive, faljes së borxhit ose përmes financimit qeveritar. (Venera Demukaj)

ASISTENCA SOCIALE (TRANSFERET). E referuar shpeshherë si ndihma publike, përfshin mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë financiare dhe jofinanciare për qytetarët e një vendi nga fondet përkatëse publike, pra nga buxheti. Të drejtë në asistencë sociale kanë kryesisht individët apo familjet që nuk arrijnë t’i mbulojnë kostot bazike të jetesës. Përgjegjës për asistencën sociale në Kosovë është Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Asistenca sociale ofrohet për familjet pa burime dhe pa anëtarë të familjes të aftë për të punuar. Kjo ndihmë ofrohet në formë monetare mujore edhe për individët me aftësi të kufizuar (përfshirë dhe fëmijët), për pensionistët, të cilët gëzojnë të drejtën e pensionit sipas ligjeve në fuqi, si dhe për kategoritë e invalidëve të luftës dhe familjet e dëshmorëve. Përkrahja për kategoritë sociale në Kosovë realizohet përmes këtyre skemave sociale: skema e asistencës sociale (nga viti 2000) dhe skema e nevojave të veçanta (nga viti 2003), skema e invalidëve të luftës dhe të afërmeve të tyre (nga viti 2001), skema e pensionit themelor (nga viti 2002) dhe e pensionit të kontribuesve (nga viti 2008), skema e pensioneve për aftësi të kufizuar (nga

viti 2004), skema e pensioneve të Trepçës (nga viti 2003) dhe skema e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar (nga viti 2009). Në mesatare, asistencë sociale si proporcion i shpenzimeve buxhetore në Kosovë sillet nga 18-22%. (Lumir Abdixhiku)

ASLLANI Adnan (1970-). Gazetar, dizajner. Lindi në Strezoc të Preshevës. Në Ferizaj vijoi shkollimin e mesëm, ndërsa në Zvicër mbaroi studimet për film dhe animacion. Si gjimnazist në Ferizaj veprroi në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, më vonë Lëvizja për Republikën e Kosovës (LPK). Në shtator të vitit 1988 u arrestua dhe u dënua me dy vjet burgim. Drejtoi mbledhjen e katërt të përgjithshme të LPK-së në Prishtinë (më 26 dhe 27 korrik 1993), ku u vendos përgatitja për luftën e armatosur. Pas burgosjeve që ndodhën në Kosovë, bashkë me veprimtarë të tjerë kaloi në ilegalitet të plotë, ndërsa në vitin 1994 emigroi në Zvicër. Ishte redaktor i gazetës së LPK-së, “Zëri i Kosovës”, e nga viti 1998 edhe kryeredaktor i saj. Është dizajner i emblemës së UÇK-së. Pas çlirimit disa muaj qëndroi në Kosovë. Jeton dhe punon në Zvicër. (Muhamet Mavraj)

ASLLANI Isak (1945-). Pikturor. Lindi në Dunavë të Gjilanit. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Gjilan, ndërsa në Prishtinë kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ, kurse në Beograd mbaroi studimet për pikturë, në Fakultetin e Arteve (1972). Nga ajo kohë u vendos në Beograd, ku mori pjesë në shumë ekspozita dhe shpërfaqti dendur peizazhet e vendlindjes, të Karadakut dhe të Gjilanit, por edhe të Kosovës, si bie fjala në veprat “Çerdhja”, “Bregoret”, “Bariu me dele” etj. U mor me pikturë, fotografi, instilacione, ndërsa kohët e fundit i është përkushtuar skulpturës, duke marrë pjesë në shumë simpoziume dhe duke realizuar vepra në gur, dru, bronz etj. Organizoi disa ekspozita personale në galeritë e Beogradit dhe më gjerë, ndërsa mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive. Jeton dhe krijon në Beograd. (Bislim Aliu)

ASLLANI Kosovare (1989-). Futbolliste. Lindi në qytetin e Kristianstadit në Suedi. Është me prejardhje nga Kosova, e rritur dhe e shkolluar në Suedi. Që e re filloi të merret me futboll.

Hapat e parë i bëri te skuadra “Vimmerby IF”, ndërsa karrierën e futbollistes profesioniste e nisi te “Linkopings FC” në vitin 2007. Aty luajti deri më 2009 dhe pati 37 paraqitje, duke shënuar 21 gola. Më pas kaloi te “Chicago Red Stars”, pastaj kthehet sërish te “Linkopings FC”. Në Vitin 2012 kaloi te skuadra “Kristianstads DFF” dhe që andej të klubi francez “Paris Saint-Germain”. Ka fituar disa trofe me ekipin e saj. Në edicionin 2014/15 ishte në finale të ligës së kampionëve për femra. Nga viti 2008 është e përfshirë edhe në kombëtaren e Suedisë, ku i ka 69 paraqitje, duke shënuar 20 gola. (Leutrim Mustafa)

ASOCIACIONI I GAZETARËVE TË KOSOVËS (AGK). Shoqatë e gazetarëve të Kosovës e themeluar në vitin 2002. Synimi i themeluesve të Asociacionit ishte promovimi, inkurajimi dhe angazhimi për të përmirësuar pozitën e gazetarëve në shoqërinë kosovare. AGK-ja ka për qëllim që të avancojë standarde të larta profesionale, të avokojë për të drejtat e gazetarëve dhe të sigurojë mjedis të sigurt pune. Ajo ngrit zërin e përkrahjes për të drejtat e gazetarëve në forume lokale dhe ndërkombëtare. AGK-ja është e organizuar në baza vullnetare dhe anëtarë të saj janë gazetarë të medias së shkruar dhe asaj elektronike: të gazetave, televizioneve, radiove, portaleve, agjencive të lajmeve etj. Asociacioni ka organet drejtuese: kryetarin, bordin, kuvendin etj. AGK-ja përkrah parimet e Deklaratës së Federatës Europiane të Gazetarëve (EFJ) dhe të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve për lirinë e medie në Europë, e miratuar më 5 mars 1993 përkatësisht më 2 mars të vitit 1995. (Artan Krasniqi)

ATALIATI Mihail (gjysma parë e shek. XI-pas vitit 1079). Shkrimtar e historian bizantin, avokat në Konstandinopojë dhe kryesues i gjyqit ushtarak në kohën e perandorëve Romani IV Diogjen (1068-1071) dhe Mihaili VII Dukas (1071-1078). Përveç veprës së rëndësishme nga lëmi i drejtësisë, ka lënë dhe një vepër historike të papërfunduar me titull “Historia”, të cilën ia kishte kushtuar perandorit Nijfori III. Në aspektin kronologjik aty trajton luftimet ndërmjet sllavëve e Bizantit, luftërat e brendshme në Bizant dhe, në këtë kontekst, përfshirjen e arbërve në këto luftëra (1034-1079). Trajtimin e ngjarjeve historike të kohës i mbështet kryesisht në përjetime dhe rrëfime

të dëgjuara. “Historia” e Ataliatit ka rëndësi burimore jo vetëm si vepër e parë e njohur bizantine që i përmend albanët ose arbanitët, sipas emrit të tyre etnik (Ἀλβανοί, Ἀρβανίτες), por edhe pse përmban të dhëna të rëndësishme për arbërorët në luftëra kundër Bizantit (1038-1040), kryengritjen e Pjetër Delianit dhe shtypjen e saj (1040-1041); pjesëmarrjen e arbërorëve në kryengritjen e dukës së themës së Sicilisë, Gjergj Maniakut (1043); sulmet e uzëve në Ilirik (1064); kryengritjen e Niqifor Brienit në Durrës (1077); pjesëmarrjen e arbërve në kryengritjen e Niqifor Vasillaqit (1078) etj. Vepra e Ataliatit mbetet një burim i rëndësishëm për Bizantin dhe Ballkanin, si dhe pikë reference kryesore për historinë e arbëve në shek. XI. (Jahja Drançolli, Qerim Dalipi)

ATLETIKA. Fillet e atletikës në Kosovë nisin më 1945, kur mbahen garat e para, ndërsa njëmbëdhjetë vjet më pas, në Prishtinë mbahet edhe kampionati i atletikës në njëmbëdhjetë disiplina për meshkuj dhe femra. Edhe ky sport në rrethanat e luftës që nga vitit 1991 organizoi garat në vrapime, pa pasur mundësi, për shkak të mungesës së kushteve. Kosova ka dhënë disa emra të njohur të atletikës, si: Nexhmedin Ibishi, Ismet Abazi, Adnan Demalia, Stevan Vuloviq, Ismet Rushiti etj. Që nga paslufta në Prishtinë me sukses mbahet gjysmëmarratona ndërkombëtare. Federata Atletike e Kosovës që nga viti 2016 është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Atletikës (IAAF). (Xhavit Kajtazi)

AUTOSTRADA “IBRAHIM RUGOVA”. Pjesë e autostradës Durrës-Merdat, e njohur edhe si “Rruga e Kombit”. Është projekti me madhor i infrastrukturës rrugore në Shqipëri



PAMJE E AUTOSTRADËS “IBRAHIM RUGOVA” (“RRUGA E KOMBIT”)

dhe në Kosovë. Gjatësia e rrugës së kombit (Durrës-Merdat) është afërsisht 270 km. Pjesa që shtrihet në territorin e Shqipërisë është e gjatë 170 km, fillon në Durrës dhe përfundon në pikën kufitare të Morinës dhe ka dy korsi në të dy drejtimet. Në pjesën e Shqipërisë, në Kalimash, në malet afër Kukësit, autostrada kalon nëpër një tunel me gjatësi 5.5 km. Pjesa në territorin e Kosovës është e gjatë 100,4 km dhe fillon në pikën kufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, në Morinë, ndërsa përfundon në pikën kufitare me Serbinë, në Merdat. Kjo pjesë e autostradës është emërtuar me emrin e dr. Ibrahim Rugovës, në respekt të idesë fillestare të Presidentit Rugova lidhur me këtë rrugë. Rëndësia e kësaj rruge është e madhe dhe shumëdimensionale për të dy vendet, por dhe me gjerë. Ajo ndihmon lidhjet ekonomike midis dy vendeve, integrimet rajonale dhe europiane. (Valon Murtezaj)

AVARËT. Popull nomad mongol, me përkatësi të papërcaktuar gjuhësore, i cili në shek. VI-IX luajti rol të rëndësishëm në Europën Lindore dhe Juglindore. Avarët fillimisht jetonin në lidhje fisnore në një territor të gjerë, që nga Koreja deri në kurorën e maleve Tien Shan, në Azinë Qendrore. Turqit atlatj shpartalluan avarët në shek. VI dhe një pjesë e tyre shkoi gjurmëve të hunëve, të cilët rreth vitit 558 depërtuan në vendin e elanëve të Kaukazit. Gjatë rrugës atyre iu bashkuan turqit ujgurë. Meqenëse perandorët bizantinë, Justiniani I (527-565) dhe Justini II (565-578) nuk lejuan vendosjen e avarëve në Dobrukhë (Bullgari), ata kaluan në territorin midis detit Azov dhe Shlezisë. Pas vendosjes së longobardëve në Itali (568), avarët u bënë zotë të gjithë ultësirës së Panonisë. Më pas avarët u shtrinë në një territor të gjerë, ndërsa kulmin e zhvillimit e mbërritën në shek. VI, kur perandoria e tyre njohu një shtrirje midis Adriatikut dhe detit Baltik. Sipas disa studuesve, avarët ishin shkaktarë për migrimin e kroatëve dhe serbëve në jug (Ballkan). Nën presionin e turqve ata u tërhoqën në krahinën e mesme të Danubit, rrethuan Konstandinopojën dhe Selanikun (617), me ç’rast pësuan disfatë, e cila i përcolli edhe në luftëra me bullgarët. Një pjesë e avarve ishte ngulitur edhe në Dardanië Veriore (Luginë të Moravës). Pas marrëveshjes me Bizantin (679), avarët jetuan në paqe. Shteti avar u dobësua sërish pas krijimit të shtetit

bullgar në Ballkan (680), si dhe pas disfatave të vazhdueshme nga ushtritë e Karlit të Madh gjatë viteve 791-803. Në vitin 828 avarët përfundimisht iu nënshtruan mbretit frank, për t'u asimiluar më pastaj pothuajse tërësisht në mesin e popullatës vendore, të ardhësve sllavë dhe kolonistëve gjermanë. (Ramiz Abdyl)li)

AVDIJA ZUFER (1960-). Basketbollist, trajner. Lindi në Prishtinë. Filloi karrierën sportive që në moshën 15-vjeçare, kur nisi të luante futboll për KNI "Ramiz Sadiku" të Prishtinës, në rolin e portierit. Si 16-vjeçar kaloi në Klubin e basketbollit "Elektrokosova" (tash "Prishtina"), nën udhëheqjen e trajnerit Bardhyl Nushi. Pas katër muaj ushtrimesh u përfshi në skuadrën e parë. Talenti i tij iu ra në sy skuadrave jashtë Kosovës. Angazhimi i tij më i suksesshëm ishte te "Cërvena Zvezda" e Beogradit, ku u bë edhe kapiten i skuadrës. Ndërkohë u ftua edhe në përfaqësuesen e ish-Jugosllavisë, me të cilën fitoi medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror të vitit 1982 në Kolumbi. Pjesën më të gjatë të karrierës sportive e kaloi në Izrael, plot njëzetepesë vjet, fillimisht si lojtar, më pas si zëvendëstrajner i "Macabit" në Tel-Aviv dhe drejtues i shkollës së basketbollit për të rinj të kësaj skuadre. (Leutrim Mustafa)

AVDIU AVDI (1934-1995). Mjek, dermatovenerolog, profesor universiteti. Lindi në Gadime të Lipjanit, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje dhe në Ferizaj, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Filloi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, në vitin 1959 u akuzua si organizator i protestës në konviktin e studentëve dhe u dënua me 3 vjet burg. Pas daljes nga burgu, vazhdoi studimet dhe u diplomua në vitin 1964. Një kohë të shkurtër punoi në Ferizaj dhe më pas në Tetovë, por u largua nga puna për shkaqe politike. Si mjek i papunë u detyrua të migrojë në Stamboll të Turqisë, ku hapi ordinancë private dhe punoi disa vjet. Në vitin 1972, me zbutjen e klimës politike, e braktisi Turqinë dhe u kthye në Kosovë. Fillimisht u punësua në Ferizaj e më pastaj kaloi në Zagreb, ku kreu specializimin dhe studimet pasuniversitare. U magjistrua në vitin 1978 në fushën e dermatovenerologjisë dhe më 1981 mbrojti tezën e disertacionit po nga kjo fushë. Pas punës si asistent dhe docent i lëndës dermatovenerologjisë, mori titullin e profesorit ordinar po për këtë lëndë. Botoi një

numër punimesh shkencore dhe profesionale. (Afërdita Daka)

AVDIU KAMBER (1940-2007). Gazetar. Lindi në fshatin Rekë të komunës së Mitrovicës. Në Mitrovicë kreu shkollën fillore dhe atë të mesme, ndërsa shkencat politike i kreu në Zagreb. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit. Në vitin 1968 e fillon punën gazetar në Radio Prishtinë, ndërsa më 1969 nis punë në "Rilindje", si redaktor i rubrikës së jashtme, pastaj kryeredaktor i revistës "Zëri i rinisë". Nga viti 1976 kreu detyra të ndryshme në institucionet e Kosovës, si sekretar për Informim i Komitetit Krahinor, sekretar i Pleqësisë Krahinore për Marrëdhënie me Jashtë, zëvendëssekretar për Informim i Kosovës etj. Nga fillimi i viteve '90 u kthye sërish në gazetën "Rilindja", ku punoi redaktor në rubrikën e politikës së jashtme, deri në mbyllje të kësaj gazete. (Shefqet Rexhepi)

AVDIU NYSRET (1953-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet në Fakulteti Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1976). Magjistraturën e përfundoi në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa doktoratën nga lëmi i makinave elektrike e mbrojti në Fakultetin Elektroteknik të UP-së (1993). U zgjodh asistent më 1976 dhe në vitet në vazhdim avancohet në titujt e tjerë universitarë, përfshirë dhe titullin e profesorit të rregullt për lëndët nga fusha e makinave elektrike. Kreu specializimin nga fusha e makinave elektrike dhe teoria e fushës elektromagnetike në Montreal të Kanadasë (1985) dhe realizoi vizita studimore në Darmshtad, Gjermani (2007). Fushë e interesimit të tij shkencor dhe profesional është lëmi i elektroenergjetikës dhe rregullimi ekonomik i sektorit të energjetikës. Është hartues i teksteve dhe i dispensave universitare: "Makinat asinkrone" (2014), "Shndërrimi elektromekanik" (2013), "Dinamika e makinave elektrike" (2010) dhe botoi një sërë punimesh shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare. (Isuf Krasniqi).

AVDIU RAMADAN (1964-). Veprimtar, politikan, diplomat. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën e mesme dhe studimet për ekonomi

(1993). Më pas kreu Fakultetin e Shkencave Politike dhe Sociale në Universitetin e Lozanës në Zvicër. Si i ri u bë anëtar i organizatës Fronti Nacionalçlirimtar i Kosovës. Më 1984 u arrestua dhe u dënua me 8 vjet burg. Pas lirimit nga burgu (1989) u inkuadrua në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPKR-LPK) dhe po këtë vit u zgjodh kryetar i këshillit të rrethit të LPRK-së për Prishtinë dhe anëtar i kryesisë qendrore. Në vitin 1990 u zgjodh sekretar organizativ i LPK-së. Pas fushatës së arrestimeve të veprimtarëve shqiptarë në gusht të vitit 1993 emigroi në Zvicër. U caktua redaktor në gazetën “Zëri i Kosovës” dhe u zgjodh kryetar i nëndegës së LPK-së për Zvicër. Në periudhën 1998-1999 ishte anëtarë i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas luftës u zgjodh anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe sekretar i saj për marrëdhënie me jashtë (2003-2006). Në vitin 2007 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës dhe, së fundi, Konsull i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Gjenevë (2013). (Ruzhdi Jashari)

AVDIU Sadullah (1959-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Lluçan të Bujanocit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Bujanoc dhe Fakultetin Teknik në Prishtinë. Kreu studimet e magjistraturës dhe të doktoratës në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (2003). Në fillim zuri punë në shkollën e mesme në Bujanoc, kurse nga viti 1984 punon në Fakultetin e Makinerisë të UP-së, ku mori titujt përkatës universitarë (profesor i rregullt, 2011). Përveç në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së, mbajti ligjërata edhe në disa njësi të tjera akademike. Ushtroi funksione të ndryshme në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe ishte kryetar i Komitetit për Makineri në Agjencinë për Standardizim. Është autor i disa teksteve universitare: “Vizatimi me kompjuter” (1999), “Konstruktimi me kompjuter” (2003), “Metodika e konstruktimit” (2005) etj. dhe mori pjesë në disa simpoziume dhe konferenca me punime shkencore dhe profesionale. Për nevoja të ekonomisë së Kosovës ka kryer disa projekte nga fusha e makinerisë. (Musli Bajraktari)

AVDYLI Brahim (1960). Poet, publicist. Lindi në fshatin Morinë të Malësisë së Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Ponoshec, gjimnazin

në Gjakovë. Studimet i filloi në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa më vonë i vazhdoi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Me krijimtari letrare filloi të merret që në shkollë të mesme. Shkruan kryesisht poezi për të rritur. Ka botuar shkrime, artikuj dhe analiza publicistike në gazeta e revista të ndryshme. Gjatë viteve 1990-1995 ka udhëhequr revistën “Qëndresa”, që dilte në Zvicër. Ka botuar këta libra me poezi: “Në hijen e Alpeve”, “Buka e kuqe”, “Kur zgjohet Dodona”, “Pasqyrë e përgjakur”, Klithje nga fundi i ferrit” (2000), “Gjuha e dheut tim” (1999), “Baraspesha e humbur” (2003), “Qielli i paprekur” (2012). Ka botuar gjithashtu edhe dy libra tregimesh: “Vragat e një kohe” (2005) dhe “Lëvozhga e vdekjes” (2007). Poezia e Brahim Avdyli është përkthyer në disa gjuhë të huaja. (Nazmi Rrahmani)

AVDYLI Merxhan (1961-). Shkrimtar. Lindi në Sadovinë të Jerlive të Vitisë. Shkollën fillore e kreu në Goshicë, kurse gjimnazin në Viti. Kreu studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti temën e doktoratës (2012). Gjatë studimeve ishte aktiv në lëvizjen studentore, derisa u burgos në vitin 1981. Pas daljes nga burgu (1990) u përfshi në aktivitetet politike. Poezitë e para i botoi nga fundi i viteve ‘70 në revistat “Zëri i rinisë” dhe “Bota e re”. Pas luftës ishte redaktor në Radion “Kosova e lirë” dhe redaktor i gazetës “Zëri i Kosovës” (2000). Në periudhën 2000-2008 ka qenë këshilltar politik dhe zëvendësministër. Nga viti shkollor 2010/11 është i angazhuar në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, dega në Prizren, ligjërues i lëndës letërsi bashkëkohore shqipe dhe redaktor në Institucionin e Avokatit të Popullit. Botoi një sërë veprash me poezi, prozë dhe kritikë letrare: “Libri i Lirisë” (1991), “Fati i flijuar” (1994), “Shpërfillësi i madh” (2004), “Fati i pakryer” (2006), “Deti i dashurisë” (2013), “Antologji egoiste” (2013), “Sprova zbuluese të poetikës” (2005), “Studime për Agollin në Kosovë” (2006), “Përsosmëria shkrimore - poetika e romanit ‘Kronikë në gur’ e Ismail Kadaresë” (2009), “Dritësime letrare” (2013) etj. (Shaip Beqiri)

AVGUSTINI Imzot Lucjan (1963-). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Ferizaj. Familja e

tij rrjedh nga Zymi i Hasit. Kreu Fakultetin Teologjik në Zagreb. Në vitin 1989 u shugurua meshtar në Zym të Hasit. Më 1991 shkoi në Shqipëri, si i dërguar i imzot Nikë Prelës. Mori pjesë në hapjen e shtëpisë së parë të murgeshave të “Nënë Terezës” në Tiranë dhe në hapjen e kishës katedrale në Shkodër. Në vitin 1992 u emërua drejtor i Caritas-it të sapoformuar të Kosovës, përkatësisht në vitin 1993 u emërua famullitar në Ferizaj. Në vitin 1994 shkoi në Argjipeshkvinë e Shkodrës, ku një vit më vonë u emërua famullitar në Katedralen e Shkodrës. Në vitin 1997 mori titullin imzot. Në dhjetor të vitit 2006 u emërua ipeshkëvi i Dioqezës së Sapës, kurse më 2007 u shugurua ipeshkëvi në Katedralen “Nënë Tereza” në Vaun e Dejës. (Frrok Kristaj)

AVOKATI I POPULLIT. Institucion i pavarur për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Si “Ombudsman” ka origjinën nga Suedia, ku Parlamenti i këtij vendi që nga viti 1809, me qëllim të zgjidhjes së kontestit për ndarjen e autorizimeve ndërmjet mbretit dhe Parlamentit, kishte emëruar një ndërmjetësues të popullit, duke ia lënë mbretit pushtetin ekzekutiv, ndërsa Parlamentit pushtetin ligjdhënës. Më herët variante të një institucioni të tillë njiheshin edhe në periudhën antike (Spartë, Athinë, Kinë etj.). Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (kapitulli XII, neni 134, në 5 pika dhe neni 135, pika 4), kompetenca kryesore e Avokatit të Popullit është të sigurojë se të gjithë zyrtarët i ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të drejtë, me nder dhe me përgjegjësi publike. Avokati i Popullit shqyrton të gjitha rastet e zbatimit jo të drejtë të ligjeve, tejkalimit të autorizimeve ose mospërbushjen e obligimeve të tyre ndaj qytetarëve. Është institucion i pavarur, që mbron të drejtat dhe liritë e individit të përcaktuara me standardet ndërkombëtare. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, me mandat 5-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, jopartiak, i ndershëm, me moral të lartë, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut. (Osman Ismaili)

AVOKATURA. Jurist i pavarur që u ofron ndihmë juridike profesionale qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike. Ndihma juridike përfshin dhënien e këshillave dhe mendi-

meve juridike: hartimin e padive, kërkesave, propozimeve, lutjeve, mjeteve juridike dhe parashtrësive, hartimin e kontratave, marrëveshjeve, testamenteve, deklaratave etj. Avokati duhet të jetë i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, e cila ka organet e saj, përfshirë edhe Këshillin Mbikëqyrës, Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, Gjykatën Disiplinore etj. Avokati i huaj i licencuar mund të ushtrojë funksionin e avokatit në Republikën e Kosovës në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe aktet e Odës. Avokati është i detyruar të ofrojë ndihmën juridike në mënyrë profesionale, të ndërgjegjshme, të denjë dhe në pajtim me ligjin përkatës, statutin dhe kodin, të ruajë fshehtësinë e të dhënave, fakteve dhe informatave që i janë dhënë gjatë përfaqësimit të klientëve. Avokati ka të drejtë për pagesën e honorarit dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e tij në pajtim me rregulloren për tarifën e avokatëve. Në Republikën e Kosovës e ushtrojnë profesionin e avokatisë afro 600 avokatë të regjistruar. (Osman Ismaili)

AXHIZI Sheh Sylejman (-1747). Sheh i tarikatis Saadi, poet i divanit. Lindi në Shkodër në gjysmën e dytë të shek. XVII. Kreu studimet në Stamboll, ndërsa mësimet nga sufizmi dhe gnostika islame i mori në Sham (Siri), ku mori diplomën për sheh. Në vitin 1699 erdhi në Gjakovë, ku, me mbështetjen e Kryezinjve, ngriti Teqenë e Madhe (1714) dhe filloi aktivitetin për përhapjen e tarikatis Saadi. U angazhua edhe në aktivitete politike të kohës. Në vitin 1717, përkrah Mehmet Kurt Pashë Gjakovës, mori pjesë në betejën e Ulqinit kundër venedikasve. Në shenjë ngadhënjimi në këtë betejë, skaliti një mbishkrim në Kalanë e Ulqinit, i cili qëndron edhe sot. Para vitit 1730 u shpërngul nga Gjakova në Prizren, ku ngriti teqenë e tij të dytë (1743). La në dorëshkrim një divan të shkruar në gjuhën perse, arabe dhe osmane, i cili është ruajtur në katër kopje të ndryshme. Disa poezi të tij këndohen si ilahi në teqetë e saadinjve dhe në teqe të tjera. Vdiq në Prizren dhe u varros pranë teqesë së tij në Marash, ku pasardhësit i ngritën tyrben, e cila vizitohet edhe sot. (Nehat Krasniqi)

AZEMI Edmond (1980-). Basketbollist. Lindi në Doboj (BeH). Nisi karrierën si basketbollist në KB “Prishtina”. Përveç në “Prishtinë”, luajti edhe në Maqedoni me skuadrat “Liria” dhe

“MZT Skopje”. Luajti edhe në përfaqësuesen e Shqipërisë dhe të Kroacisë. Llogaritet një prej basketbollistëve më të mirë të Kosovës. Me “Prishtinën” ka fituar shumë tituj të kampionit të Kosovës, ndërsa nën drejtimin e tij “Prishtina” ka dalë fituese në Ligën Ballkanike në edicionin 2014-2015. Disa herë është zgjedhur si basketbollisti më i mirë i Kosovës. (Bekim Aliu)

AZEMI Emin (1960-). Gazetar. Lindi në fshatin Stançiq të Gjilanit. Ka mbaruar studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Filloi të merrej me gazetari qysh si student, më 1982. Ishte gazetar dhe më pastaj redaktor i kulturës në gazetën e studentëve të Universitetit të Prishtinës “Bota e re”. Ndërkohë, disa vjet punoi në gazetën “Rilindja” në Prishtinë dhe korrespondent i saj nga Shkupi. Më pas ishte korrespondent i Radios “Zëri i Amerikës”, e më vonë për disa vjet drejtoi gazetën “Bota sot” në Cyrih të Zvicrës. Nga viti 1998 drejtoi gazetën “Fakt” në Shkup. Ka bërë shkrime dhe ka bashkëpunuar me disa medie. Është autor i shkrimeve analitike-komentuese, reportazheve, intervistave etj. Ka shkruar ese, vështrime letrare, libra publicistikë dhe përmbledhje me poezi. (Zenun Çelaj)

AZEMI Ismet (1961-). Aktor. Lindi në fshatin Pollatë të Podujevës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Podujevë, studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në teatër është aktiv nga fillimi i viteve '90, kurse njërin nga rolet e tij të rëndësishme e realizoi në shfaqjen “Të mallkuarit” (1999) në Teatrin Kombëtar të Kosovës (TKK). Ishte i angazhuar pothuajse në të gjitha shtëpitë e rëndësishme teatrore në Kosovë e më gjerë, prej të cilave duhen përmendur interpretimet e tij, kryesisht në role kryesore në shfaqjet: “Një darkë me të marrë” në Teatrin e Gjakovës, “Ruleti ballkanik” në Teatrin “Bylis” në Fier, “Kaos atdhedashurie në Paris” në Teatrin e Tetovës, “Dosja H” në TKK etj. Luajti edhe në monodramën “Vrasja e Mushkonjës”, pastaj në shfaqjen “Vdekja e një komisionari”, “Vorbulla” që të gjitha të realizuara në skenën e TKK-së etj. Interpretoi role edhe në filma artistikë të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër, si “Kukumi”, “Kodi i jetës”, “Agnus Dei” të produksionit të Qendrës Kinematografike të Kosovës etj. Për kreacionet artistike mori një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh. (Besim Rexhaj)

AZEMI Nijazi (1970-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPBM), dëshmor. Lindi në fshatin Mogillë të Vitisë. Ishte bashkorganizator i demonstratave të marsit të vitit 1989 në Ferizaj, ku edhe u plagos. Me fillimin e luftës në Kosovë, që më 1988 u bashkohet radhëve të UÇK-së. Në përfundim të luftës u transferua në Zonën Operative të Karadakut, ku u përfshi në ngritjen e strukturave të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Me daljen në skenë të UÇPMB-së, u bë pjesë e saj, ndërsa më pas u emërua komandant i Brigadës 115 “Karadaku”, e cila veprroi në Zonën Operative të Preshevës dhe zëvendëskomandant i Zonës Operative të Preshevës. Ra heroikisht më 26 mars 2001 në betejën e Caravajkës. (Fehari Ramadani)

AZI Naime (1978-). Aktore. Lindi në Odër të Tetovës, ku mbaroi arsimin fillor. Kreu gjimnazin në Tetovë, ndërsa studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Realizoi një sërë rolesh në teatër dhe film. Luajti në shfaqjet: “Volpone”, “Pas vdekjes”, “Shërbëtori i dy zotërinjve”, “Mbreti Edip”, “Njeriu që pa vdekjen me sy”, “Policët”, “Lavrja e denjë për respekt”, “Kaos atdhedashurie në Paris”, “Hamleti në teatrin tonë”, “Shtëpia në kufi”, “Mori”, “Me grusht tehut të thikës”, “Çmendina” etj. Është autore e monodramës “Kush jam unë”. Mori pjesë edhe në projekte filmike. Është fituese e disa çmimeve për aktrim, si në teatër, po ashtu edhe në film. Është aktore e Teatrit të Tetovës. (Salajdin Salihu)

AZIZI Nijazi (1940-1988). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Nasalcë të Bujanocit, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në Shkollën Normale të Prishtinës, ndërsa studimet për pedagogji i bëri në Fakultetin Filozofik të Shkupit. Doktoroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Karrierën profesionale e nisi si mësëmdhënës në Shkollën Normale në Gjilan, përkatësisht në Ferizaj, ndërsa nga vitit 1965 e vazhdoi në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Ndërkohë mbajti mësim edhe në shkolla të larta pedagogjike në Gjilan, në Gjakovë etj. Mori pjesë në forma të ndryshme të kualifikimit të mësëmdhënësve. Fushë e interesimit shkencor të N. Azizit ishte

pedagogjia e përgjithshme. Mori pjesë në disa konferenca e kongrese shkencore-profesionale. Publikoi disa punime në revista të ndryshme. Është autor i veprës “Religjioziteti - ateizmi i të rinjve dhe disa çështje të edukimit ateist” (1984). (Afërdita Deva-Zuna)

AZIZI Zylfi (1941-). Mjek, gjinekolog-obstetër, profesor universiteti. Lindi në Miratoc të Preshevës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Së pari punoi në Llojan të Kumanovës dhe më pas si mjek në Klinikën e Gjinekologjisë në Prishtinë, ku kreu edhe specializimin për obstetrikë-gjinekologji dhe citodiagnostikë. Kreu studimet pasuniversitare në Beograd, ndërsa në vitin 1984 mbrojti temën e doktoratës nga



ZYLFI AZIZI

lëmi i gjinekologjisë. Që në vitin 1978 u emërua asistent, më pas profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës së gjinekologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1990 u përjashtua nga puna nga organet e dhunshme serbe dhe vazhdoi të punojë në poliklinikën private. Mbajti mësim me studentë dhe ordinancën e vet private e shndëroi në ushtrimore për studentë të Fakultetit të Mjekësisë. Mori pjesë në disa kongrese dhe simpoziume brenda dhe jashtë vendit. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Binak Kastrati)

B

BABALIJA Avdullah (1967-2015). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Brigadës 137 “Gjakova” në Zonën Operative të Dukagjinit. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Në pranverën e vitit 1998 u angazhua në radhët e UÇK-së. U emërua zëvendëskomandant i policisë ushtarake të UÇK-së i kësaj zone. Mori pjesë në beteja të shumta, që u zhvilluan në rajonin e Dukagjinit, si në Baballoç, Gramaçel, Prilep, Carrabreg, Broliq, Gërgoc, Glllogjan, Shqiponjë, Irzniq, në Çabrat të Gjakovës etj. Gjatë luftës njihet si “Komandant Syla”. Në pranverën e vitit 1999, pas formimit të Brigadës 137 “Gjakova” u emërua zëvendëskomandant i kësaj brigade dhe më vonë komandant i saj. Pas përfundimit të luftës u emërua komandant i Brigadës 332 “Gjakova” të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në Gjakovë. Më vonë u emërua zëvendëskomandant i Zonës së Tretë të TMK dhe karrierën ushtarake e përfundoi pas transformimit të TMK-së në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Manushe Ramosaj)

BABINGER Franc (Franz) 1891-1967. Historian, orientalist, albanolog dhe ballkanolog. Lindi në Vajden të Gjermanisë, krahina e Bavarisë. Kreu studimet e doktoratës në Universitetin e Munihut. Gjatë



FRANC BABINGER

Luftës së Parë Botërore shërbeu në Lindjen e Mesme, ndërsa më pas vazhdoi studimet në Universitetin “Fridrih-Vilhelms” të Berlinit, ku më 1921 u gradua me titullin e profesorit. Gjatë kësaj kohe botoi veprën “Historianët e Perandorisë Osmane dhe veprat e tyre” (Geschichtsschreiber der Os-

manen und ihre Werke, 1927), e cila shërbeu si model për gjithë ata që studionin në këtë fushë të historisë. Me ardhjen në pushtet të nazizmit nuk u pajtua me ideologjinë e tyre dhe iku në Rumani, ku ligjëroi në Universitetin e Bukureshtit dhe të Jashës. U kthye në Gjermani pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe me 1948 mori drejtimin e katedrës për turkologji, kulturë dhe histori të Lindjes së Afërme në Universitetin e Munihut. F. Babinger u mor me studimin e historisë osmane në tërësi, por në mënyrë të veçantë të shekujve XV-XVI. Opsi i tij studimor është shumë i madh dhe përfshin një sërë monografish, botime të dokumenteve dhe artikujve studimorë. Vepra e tij më e njohur është “Mehmet Pushtuesi dhe koha e tij” (1953), e përkthyer edhe në shqip. Interesimet e tij për historinë osmane dhe shqiptare janë përfshirë në disa studime, ndër të cilat veçohen: “Udhëtimi i Evlia Çelebiut në Shqipëri” (1930), “Themelimi i Elbasanit” (1931), “Fundi i Arianitëve” (1960) etj. Veprat e tij kushtuar Shqipërisë e radhisin në mesin e albanologëve më të shquar të kohës. Lidhjen e tij me Shqipërinë e dëshmoi edhe me tri vizita që ia bëri këtij vendi së pari më 1928, pastaj me 1962 dhe se fundmi më 1967, ku mori pjesë në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, me ç’rast vdiq në Durrës, më 23 qershor 1967. (Muhamet Mala)

BABIZMI. Sekt me prejardhje shiite. Themelues është Ali M. Shirazi (-1852). Më 1844 ai shpalli se është përfaqësues i predikuesit (bâb) të Imamit të Pritur. Vepra kryesore e tij “El-Bejan” përmban ide të skajshme shiite dhe sufiste, por edhe kristiane, judaiste dhe zaratustriane. Bindjet e skajshme fetare dhe bashkëpunimi me pushtuesit bëri që lideri i grupit në vitin 1850 të ekzekutohet nga qeveria iraniane. Aktualisht

në botë ka pak babistë në Uzbekistan dhe në disa shtete të Perëndimit. Ndërkaq bahaizmi, si fraksion i babizmit, u shfaq pas vdekjes së liderit të babizmit. Themelues është Mirza Husejn Ali Nuri, i njohur si Beha'ullah (-1892). Behaizmi është sekt sinkretik i përbërë nga disa religjione. Për shkak të veprimtarisë së tyre të dëmshme, unanimisht u shpall sekt antiislam. Selia e tyre gjendet në qytetin Haifa në Izrael. Janë të pranishëm në shumë vende të botës, ndërsa kanë aktivitet edhe në Tiranë, Prishtinë etj. (Nexhat Ibrahim)

BABUNI Bujar (1951-). Producent i televizionit dhe i filmit. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë dhe Prishtinë. Punoi producent në Radiotelevizionin e Prishtinës që nga themelimi i këtij institucioni (më 1974), deri me vendosjen e masave të dhunshme të Serbisë më 1990. Së pari u angazhua në sektorin e produksionit, në programin kulturor-artistik dhe në programin informativ. Nga viti 1999 vazhdoi punën në Radiotelevizionin e Kosovës. Krahas punës në TV, ishte i angazhuar si producent në të gjithë filmat e metrazhit të gjatë që janë xhiruar nga Shtëpia filmike "Kosovafilm": "Lepuri me pesë këmbë", "Njeriun prej dheu", "Pikniku", "Era dhe lisi", "Proka", "Rojet e mjegullës", "Kukumi", pastaj në filmat në Televizionin e Prishtinës: "Fidani", "Rropullari", "E kafshoja terrin" etj. (Shefqet Rexhepi)

BACAJ Mustafë (1942-2016). Kimist, profesor universitar. Lindi në Dubovë të Vogël të Istogut. Shkollimin bazë e mori në Banjë të Pejës dhe në Pejë. Studimet për kimi i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1967. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit (1976), ndërsa disertacionin e doktoratës në FSHMN të UP-së. (1981). Punoi mësimdhënës i kimisë në gjimnazin e Istogut, më pas zgjidhet asistent në seksionin e kimisë të FSHMN-së, ku i arrin të gjithë titujt universitarë. Ishte kryetar i Shoqatës së Kimistëve të Kosovës dhe kryeredaktor i revistës shkencore "Acta Chimica Kosovica". Botoi punime shkencore në revista ndërkombëtare e vendore dhe ka mbajtur kumtesa në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është bartës i projekteve shkencore, ka botuar disa tekste të kimisë

për shkolla të mesme dhe është bashkautor i një teksti universitar ("Kimia analitike, bazat teorike"). (Nexhat Daci)

BADALLAJ Imri (1943-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Zhur të Prizrenit. Shkollën normale e përfundoi në Prizren, ndërsa degën e gjuhës shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Po në këtë fakultet ka kryer studimet pasuniversitare dhe ka mbrojtur tezën e disertacionit të doktoratës për të folmen e Hasit (1986). Disertacionin e ka botuar në formë monografie (2001). Prej vitit 1974 punon si mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, ku arriti titullin profesor i rregullt. Ka ligjëruar në Universitetet e Tetovës, të Shkupit dhe të Shkodrës. Studimet e tij trajtojnë probleme të fonetikës së shqipes, të dialektologjisë dhe të standardizimit të shqipes. Ka pasur tri qëndrime specializimi në Gjermani: dy herë në Berlin, kur ka mbajtur ligjërata dhe një semestër në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Bonit. Më 1987/88 ka bërë punën e ekspertit të gjuhës shqipe në Radiotelevizionin e Pekinit dhe në katedrën e gjuhës shqipe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Pekinit. Ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe simpoziume shkencore brenda dhe jashtë Kosovës dhe ka kryer detyra të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe detyrën e drejtorit të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2007-2008). Ka qenë anëtar i Këshillit për Emërime të Larta të Kosovës. Aktualisht është anëtar i Këshillit Ndërkademik për Gjuhën Shqipe. (Shkumbin Munishi)



IMRI BADALLAJ

BADIVUKU Pranvera (1945-). Kompozitore. Lindi në Pejë, shkollën e mesme të muzikës e kreu në Shkup (1963) dhe vazhdoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, drejtimi i edukatës muzikore. Një kohë punoi si mësimdhënëse e muzikës në Shkup dhe Prishtinë. Më 1979 kaloi në produksionin muzikor të Radiotelevizionit të Prishtinës si producente dhe redaktore e muzikës për fëmijë deri në mbylljen e dhunshme të këtij institucioni (1990). Është autore e afro 200

këngëve, shumë prej të cilave të mbështetura në melosin popullor. Vend të dukshëm zënë këngët për fëmijë. Ka marrë çmime të shumta: “Okarinën e artë” në “Akordet e Kosovës, pesë herë me radhë (1967-1989). Krijimet e saj janë shquar dhe në festivale të tjera, si “Zambaku i Prizrenit”, festivali i këngës në Gjakovë, në Novi-Sad, Shkodër etj. Ka bërë dhe aranzhmane këngësh në frymën e melosit popullor. Shquhen këngët: “Eja e bardha verë”, “E kujtoj atë takim”, “Kur ti buzëqesh”, etj. dhe këngët për fëmijë: “Vallja e shkronjave”, “Stinët e vitit” etj. Vazhdon të jetë aktive në krijimtari muzikore. (Besa Luzha)

BADIVUKU-BASHA Zana (1972-). Pianiste, profesore universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, drejtimi i pianos (1995), ku mori dhe titullin master i arteve (2008) në fushën e solfezhit. Si pedagogje e pianos punoi në Shkollën e Muzikës në Prishtinë (1994-1996) dhe në Shkollën e Muzikës në Pejë (2001-2014). Nga viti 1996 u angazhua në Fakultetin e Arteve të UP-së, ku mori titullin e profesorit për lëndën solfezh (2013). Ligjëroi edhe në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë nga viti 2013. Si korrepititore realizoi koncerte në festivale e aktivitete muzikore në Prishtinë: “Kamerfest” (2004, 2006, 2007), “Re-Musica” (2008), “Shopen Piano Fest” (2011), “European Summer Music Academy” (2012), “100 vjet Pavarësi e Shqipërisë”, “Ditët e Muzikës Kosovare” (2011, 2012). Ishte korrepititore në masterklasët “Multi kulti” në Strugë (2003-2006), anëtare e jurisë në garat “Ars Kosova” në Prishtinë (2014). (Indira Çipo)

BADIVUKU-HOXHA Sihana (1967-). Violiniste, profesore universiteti. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës, studioi për violinë dhe u diplomua në Konservatorin Shtetëror “P.



SIHANA
BADIVUKU-HOXHA

I .Çajkovski” në Moskë, ku kreu dhe studimet pasuniversitare (klasa prof. E.Chugajeva, 1983-1991). Në vitet 1993/94 studioi në Hochschule für Musik në Detmold, në Gjermani (klasa e prof. Young Uck Kim).

Më 1994 mbaroi kursin e perfeksionimit në “Academia Chigiana” të Sienës (Itali) te prof. Uto Ughi. Mori pjesë në garat ndërkombëtare për violinë (Lajpcig, Gorizia, Budapest), në festivalet ndërkombëtare “Vera e Ohrit”, “Inter Fest” (Manastir), “Ditët e Muzikës Maqedonase”, “Ditët Ndërkombëtare të Muzikës së Dhomës” (Tiranë), “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Gubbio-Festival” (Itali), Festivali “Re-Musica” (Prishtinë), Festivali i muzikës klasike “Varna” (Bullgari), Festivali “Muzina” (Slloveni), “Java e Bach-ut”, Festivali Ndërkombëtar “Kamerfest” (Prishtinë). Është prezantuar në Festivalin “Vera e Ohrit 98” me Orkestrën Filarmonike të Radiotelevizionit të Vjenës (ORF) dhe ka koncertuar në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Bullgari, Gjermani, Itali, Rusi, Finlandë, Irlandë, Spanjë, Slloveni, SHBA etj. Anëtare në ansamblet “Vivendi” dhe i Trios harkore “Kosova”. U prezantua në Festivalin “Vera e Ohrit 2003” me Ansamblin “Musica balcanica”. Nga viti 2000, si drejtoreshë artistike është angazhuar në bashkorganizimin e ngjarjeve muzikore “Java e Bach-ut”, Festivali Ndërkombëtar i Muzikës “Kamerfest”, Garat Ndërkombëtare Muzikore-Prishtinë, Koncertet e Talenteve të Reja (SHAMK, Fondacioni “Ars Kosova”). Nga viti 2000 është dhe anëtare e Këshillit të Shoqatës së Artistëve Muzikorë dhe Baletit të Maqedonisë, ndërsa më 2003-2005 anëtare e Këshillit Artistik të Festivalit Ndërkombëtar “Vera e Ohrit”. Është mësimdhënëse e violinës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Sami Piraj)

BAFTIARI Shkëlzen (1986-). Pianist. Lindi në Tetovë, ku vijoi mësimet e para të muzikës. Kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës në Shkup. U diplomua në Fakultetin e Muzikës



SHKËLZEN
BAFTIARI

po në Shkup (2009), ku kreu dhe studimet pasuniversitare me “Cum Laude” (2010). Fitues i shpërblimeve shtetërore e ndërkombëtare: dy vjet me radhë çmimi II në Bllagoevgrad (Bullgari), çmimi II në konkursin “V. Vučkoviç” (Beograd), çmimi I në konkursin “V. Bucchi” (Romë), çmimi II në konkursin “N. Rubinstein” (Paris), çmimi II në Torino, çmimi I në konkursin “Shuman-Brahms” në Pllovdiv, çmimi I në

garat e Maqedonisë (2007), çmimi I në “Perlat e liqenit” (Strugë, 2013). Ka dhënë koncerte-recitale në Tetovë, Shkup, Strugë, Prishtinë, Tiranë, Sofje, Beograd, Plovddiv, Romë, si dhe në Festivalin Ndërkombëtar “Vera e Ohrit”. Ka qenë solist me Filarmoninë e Maqedonisë, me Orkestrën e Fakultetit të Muzikës në Shkup dhe ka realizuar incizime për Radiotelevizionin e Maqedonisë, Radiotelevizionin Shqiptar dhe Radiotelevizionin e Kosovës. Është profesor i pianos në Universitetin e Tetovës dhe koncertant aktiv. (Indira Çipa)

BAGERI Josif (1868-1915). Poet, shkrimtar, publicist, veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Lindi në fshatin Nistrovë të Rekës së Epërme, që asokohe i takonte sanxhakut të Dibrës. Fëmijëri-



JOSIF BAGERI

në dhe rininë e hershme e kaloi në vendlindje. Shkrim-leximin shqip e mësoi në moshën 17-vjeçare në Sofje, ku shkoi si mërgimtar. Një kohë ushtroi zanatin e këpucarit. Qe njëri ndër themeluesit dhe aktivistët e Shoqërisë shqiptare “Dëshira”, e cila u themelua në Sofje, më 1 janar 1893. Më 1899 vizitoi në Stamboll Naim Frashërin, i cili pati ndikim të madh në veprimtarinë e tij letrare dhe atdhetare. Gjatë viteve 1905-1907 punoi në përhapjen e arsimit dhe hapjen e shkollave shqipe. Më 1908 hapi shkollën shqipe në Nistrovë. Në vitin 1910 themeloi në Sofje gazetën “Shqypeja e Shqipnisë”. Pas vitit 1912 u vendos në Durrës dhe u emërua kryeredaktor i revistës “Ushtima e Krujës”. Botoi poezi, prozë, komente, reagime dhe shkrime të tjera letrare dhe publicistike. Ishte bashkëpunëtor i ngushtë me figura të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe të pavarësisë së Shqipërisë. Vdiq në Prishtinë, gjatë një udhëtimi nga Durrësi për në Sofje. (Fatmir Sulejmani)

BAHTIRI Bajram (1961-1984). Veprimtar i lëvizjes çlirimtare, dëshmor. Lindi në Prishtinë. Që në vitin 1980 u përfshi në veprimtari politike ilegale, në kuadër të Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi dhe më pas të Frontit Nacional-Çlirimtar të Kosovës (më vonë Fronti për Çlirim Kombëtar). Mori pjesë në organizimin e demonstratave të vitit 1981, për çarsye u arrestua dhe u mbajt 60 ditë në

paraburgim. Në janar të vitit 1984 u arrestua për herën e dytë, për një javë u torturua nga policia dhe më pas u lirua. Disa ditë më pas, më 8 shkurt 1984, policia tentoi ta arrestonte sërish, por ai me armë çau rrethimin e policisë dhe u pozicionua në kodrën mbi shtëpinë e tij. U vra me snajper nga njësi speciale e policisë. U varros në varrezat e Prishtinës, nga një rreth i ngushtë familjar. Pas çlirimit u nderua me çmime dhe dekorata të ndryshme nga institucionet e Kosovës. (Ilir Ulaj)

BAJÇINCA Isa (1940-2015). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në fshatin Bardhi i Madh të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë (1961).



ISA BAJÇINCA

Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Një kohë ishte këshilltar i gjuhës shqipe në Entin Pedagogjik të Prishtinës. Më 1969 u zgjodh asistent në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, më vonë ligjërues i sintaksës së gjuhës shqipe. Mbajti mësim të sintaksës edhe në katedrën e albanologjisë në Beograd. Ishte shef i degës së gjuhës shqipe dhe prodekan i Fakultetit të Filologjisë. Mori pjesë në Konsultën gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe ishte delegat në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë (1972). U mor me çështje gjuhësore, të drejtshkrimit dhe të sintaksës. Një kohë ishte sekretar i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Botoi tekste shkollore. Ishte anëtar i Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe. (Agnesa Hasimja)

BAJÇINOVC I Bujar (1965-). Inxhinier i arkitekturës, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, përfshirë edhe studimet e arkitekturës në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës. Kreu studimet e doktoratës nga lëmi i arkitekturës në Universitetin e Sarajevës. Në vitin 1991 u zgjodh asistent dhe më pas ligjërues për lëndët dizajni industrial dhe sistemet bashkëkohore në objekte në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës. Nga viti 1992 ishte projektuesi kryesor i disa veprave, si zgjerimi i Aeroportit

të Prishtinës, kompleksi i ndërtesave në Aeroportin e Prishtinës, hyrja në selinë e KFOR-it në Prishtinë, ndërtesa e UNDP-së në Prishtinë, palestra sportive në Drenas, ndërtesa banimi, enterierë etj. Me punime shkencore ka marrë pjesë në dy konferenca ndërkombëtare të mbajtura në Sarajevë. (Flamur Doli).

BAJÇINOVC I Silvana (1955-). Aktore. Lindi në Stantërg të Mitrovicës, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Me aktrim filloi të merret në moshë të re. Në vitin 1975 u angazhua si aktore profesioniste në Teatrin e Kombësive në Shkup. Në vitet '80 ishte njëra prej aktoreve kryesore e këtij institucioni dhe bartëse e projekteve më të rëndësishme të realizuara në këtë teatër. Realizoi një sërë rolesh, shumë prej tyre role kryesore. Ndër projektet më të rëndësishme, ku aktroi janë shfaqjet: "Bashkëshortët" e M. Qenës, "Nita" e J. Relës, "Anija e vjetër" e R. Shabanit, "Pahintikë në ëndërr" e Xh. Ahmetit, "Mblesëria" e Çehovit etj. Në vitin 2009 u angazhua në dramën "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të I. Kadaresë, me regji të D. Mustafiqit, që u vu në skenën e Teatrit Shqiptar në Shkup. Aktroi në disa filma, sikurse: "Rojet e mjegullës", "Lulepjeshkat e dashurisë" etj. U vlerësua nga kritika teatrore për lojën e veçantë dhe zërin melodik. Fitoi disa çmime kombëtare dhe ndërkombëtare në festivale prestigjioze të organizuara në qytete të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Është aktore e Teatrit Shqiptar në Shkup. (Salajdin Salihu)


BAJGORA Sabri (1964-). Teolog islam, mësimdhënës. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe Medresenë "Alaudin". Mbaroi studimet në Universitetin "Al-Az'har" në Kajro (1989) në Fakultetin Usuli-Din, dega e tefsirit. Pas përfundimit të studimeve u punësua në Bashkësinë Islame si vaiz-ligjërues në Xhaminë e Madhe në Prishtinë (1991), ndërsa një vit më vonë u emërua në detyrën e kryeimamit në kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Në periudhën 1995-2005 ligjëroi lëndën e tefsirit në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Ishte kryetar i Shoqatës së Ylemave të Kosovës (1993-1997), ndërsa në periudhën 1996-2000 kryeredaktor i revistës "Dituria islame". Që në moshë të re filloi të botojë shkrime në shtypin fetar brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në disa seminare, simpoziume e konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Është

autor i botimit për shkatërrimin e xhamive në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, që u botua edhe në gjuhën angleze, pastaj i monografive fetare "Komentimi i Sures Jasin" (2014) etj. (Ramadan Shkodra)

BAJRA Ismail (1929-1996). Gazetar, politikan. Lindi në Istog. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse shkollën normale në Gjakovë. Studimet i filloi në Nish, ndërsa i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Së pari punoi mësues në Istog e rrethinë, e pastaj inspektor shkollash në rrethin e Pejës. Bashkëpunimin me "Rilindjen" e nisi që në vitin 1947. Gjatë viteve 1960-1963 ishte redaktor i politikës së brendshme, ndërsa në vitet 1968-1973 drejtor i përgjithshëm i Ndërmarrjes "Rilindja". Në vitin 1973 u emërua drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe ishte i angazhuar në zhvillimin e marrëdhënieve kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë. Ushtroi funksione të larta partiake dhe shtetërore në Kosovë dhe në Federatën Jugosllave. Ishte anëtar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe sekretar Federativ për Informim në Qeverinë e Jugosllavisë (1978-1982). Shkroi një sërë komentesh dhe analizash politike në "Rilindje" dhe në periodikun shqip të Prishtinës. Pas demonstratave të vitit 1981 u përjashtua nga Lidhja e Komunistëve dhe u shkarkua nga të gjitha pozitat. Është autor i librit publicistik "Kultura dhe shoqëria" (1976). (Zenun Çelaj)

BAJRA Ymer (1939-2009). Gazetar. Lindi në Istog. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pejë, studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Me gazetari filloi të merret që nga viti 1964, kur nis të punojë në gazetën "Rilindja". Për 25 vjet shkroi për çështje ekonomike, informacione, raporte dhe analizat nga fusha e financave dhe politikave ekonomike. Po kështu u mor edhe me hulumtime në fushën e të drejtave të punëtorëve. Ishte korrespondenti i parë i gazetës "Rilindja" në Beograd, si dhe korrespondent disavjeçar në Bon, Gjermani. (Nehat Islami)

BAJRAJ Xhevdet (1960-). Shkrimtar, pedagog, përkthyes. Lindi në Panorc të Malishevës, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Rahovec. Studioi për letërsi e gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1999 jeton në



XHEVDET BAJRAJ

Meksiko Siti, ku arriti me bursën e Parlamentit të Shkrimtarëve. Botoi përmbledhjet poetike: “Nënë prej guri” (1988), “Emblema e vdekjes” (1993), “Copë e humbur e parajsës” (1996), “Liria e tmerrit” (2000), “Kur engjëjt qajnë” (2002), “Blues nën qiellin indian” (2003), “Dritë e zezë” (2004), “Shpuhlimi i shqiponjës” (2007) dhe më pas disa vepra në gjuhën spanjolle dhe përmbledhjen “Copa ime e qiellit” (2015). Botoi monodramën “Vrasja e mushkonjës” (2011). Në gjuhën shqipe përkthyeu: “Udhëzime për ta kapërcyer kufirin” (2005) të Luis Humberto Crosthwaite, “Mater dolorosa” (2008) të Ricardo Romero Vallejo. Në gjuhën spanjolle përkthyeu dhe botoi antologjinë e poezisë shqipe “Antologjia de poesia albanesa” (2013). Poezia e tij është përkthyer edhe në disa gjuhë të tjera. Nga viti 2002 është pedagog në Universidad Autónoma de la Ciudad de México (UACM), ku ligjeron lëndën e poezisë. (Fatmir Sulejmani)

BAJRAKTARAJ Arben (1973-). Aktor. Lindi në Isniq, ku kreu shkollimin fillor. Shkollën e mesme e kreu në Maribor në Slloveni, ku mori edhe mësimet e para për teatër. Shkollimin e mëtejshëm e vazhdoi në

ARBEN
BAJRAKTARAJ

Paris, në “Acting International” me profesorin Robert Cordier. Interpreti rolin e Antonin Dolohovit në “Harry Potter dhe Urdhri i Feniksit” (2007) dhe “Harry Potter dhe shenjtoret e vdekur” (2011), me regji të David

Yates-it, pastaj rolin e Markut nga Tropoja në filmin “Taken” (regjia Pierre Morel). Mes tjerash, interpreti rolin e Starszynsk-it në filmin “Çelësi i Sarës” (2010), që trajton fatin e një familjeje hebreje gjatë Luftës së Dytë Botërore në Francë, pastaj rolin e Hardquanonn-it në adaptimin e romanit të Viktor Hygosë “Njeriu që qesh” (2012) me regji të Jean-Pierre Amérisit; rolin e Darkos në filmin “Liria” (2009) të regjisorit Tony Gatliff, si dhe ka luajtur në filmat “Përenditë dhe njerëzit”, (çmimin “Grand Prix”, Kanë 2010), “Polisse (çmimin e jurisë,

Kanë 2011) etj. Në Kosovë ka luajtur rolin kryesor në filmin “Heroi” (2010), në regji të L. Kryeziut, si dhe në filmin e shkurtër “Ballkoni” (2013) të L. Zeqirajt. A. Bajraktaraj ka luajtur edhe në shfaqje të shumta teatrore në Francë (“Cubat” e Schillerit, “Ikja” e Gao Xingangut, “Roberto Zucco” të Koltësit, “Atentati” i Yamina Khadra-së etj.), por edhe në Kosovë e Shqipëri (“Udhëtimi në Unmikistan”, “Radio Iliria”) etj. Jeton dhe punon në Francë. (Emin Emini)

BAJRAKTARI Beqir (1921-1989). Mësues veteran dhe veprimtar. Lindi në Kishnarekë, komuna e Drenasit. Shkollën fillore në gjuhën serbe e kreu në Komoran. Pas shkollës normale (1954) kreu edhe Akademinë Pedagogjike në Prishtinë (1977). Punën e mësuesit e filloi pas Luftës së Dytë Botërore në shtëpinë e tij në Kishnarekë, për të vazhduar më pas edhe në shkolla të tjera, në Shipitullë, Siçevë të Gollakut, Graboc, Pomezetin, Lismir, Bardh i Madh etj (1970-1985). Krahas punës mësimore punoi edhe për zhdukjen e analfabetizmit dhe emancipimin e femrës fshatare. U shqua edhe për mbledhjen, krijimin dhe interpretimin e urtësisë popullore, shumë prej të cilave u botuan në “Gjurmime albanologjike”. Ishte aktiv në aksionin e pajtimit të gjaqeve. Për punën e tij mori mirënjohje dhe dekorata. (Islam Krasniqi)

BAJRAKTARI Col (Sokol) (1909-1945). Luftëtar antikomunist dhe kundërshtar i pushtetit serb në Kosovë. Lindi në fshatin Uçë të Istogut. Në vendlindje kreu katër klasë të fillores. Familja e C. Bajraktarit ishte në konflikt të vazhdueshëm me pushtetin serb. Pas vendosjes së administratës shqiptare, më 1941, për disa muaj kreu detyrën e kryetarit të komunës së Rakoshit dhe pastaj, deri në nëntor të vitit 1944, ishte komandant i forcave vullnetare të fshatrave Uçë, Cerkolez, Shushicë dhe Zhakovë të Gashit të Podgurit. Organizoi dhe u priu këtyre forcave në luftime nga Kolashini e deri në Novi-Pazar, kundër sulmeve çetnike dhe partizane serbe e malazeze. Në janar të vitit 1945 u arrestua nga organet e pushtetit serb dhe u dërgua në Kullën e Popit në Istog, ku u zhduk pa gjurmë. Ndërkohë, në përpjekje me forcat serbe të ndjekjes, u vranë edhe dy vëllezërit e tij, Bajrami e Selimi. (Muhamet Shatri)

BAJRAKTARI Destan (1930-2005). Mbledhës dhe botues i folklorit, profesor. Lindi në Therandë (Suharekë). Shkollën Normale e kreu në Gjakovë dhe Fakultetin Filozofik, dega gjuhë dhe letërsi shqipe, në Prishtinë. Punoi në arsim, në Therandë, në Komunën e Shkupit dhe në Prishtinë. Mblodhi folklor, sidomos fjalë të urta dhe u bë emër i njohur në folkloristikën shqiptare. Botoi “Fjalë të urta dhe thënie popullore, shënuar në Podrimë” (me 10,905 njësi), “Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe” (me 42,525 njësi) dhe “Këngë popullore vajzash” (2001) etj. Ishte anëtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, grupi i Suharekës. Në vitin 1959 u burgos dhe u dënua me 5 vjet burg, kur iu konfiskua biblioteka personale, të gjitha materialet folklorik dhe shkrimet e tjera letrare. Ishte bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës. La në dorëshkrim anekdota, fabula, tregime, poezi dhe një fjalor fjalësh të rralla. Hartoi tekste shkollore dhe botoi 32 vepra letrare-poetike për të rritur dhe për fëmijë. (Zymer U. Neziri)

BAJRAKTARI Gani (1949-). Skulptor, piktor. Lindi në Rudicë të Klinës. Kreu studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1977). Njëzetekatër skulptura të tij, kryesisht të personaliteteve të shquara historike dhe atdhetarëve të luftës së fundit në Kosovë janë realizuar për ambiente publike. Disa nga veprat e tij (piktura, skulptura, vizatime) janë pjesë e koleksioneve private në Itali, Zvicër, Gjermani, Spanjë, Austri dhe Kanada. Ka hapur ekspozita të pavarura në Beograd (1981), Prishtinë (1982, 1996, 2004), Pejë dhe Prizren (1996), Carpi Modena në Itali (2002), Corciano-Perugia po në Itali (2005). Nga viti 1977 është pjesëmarrës në shumë ekspozita të përbashkëta në Kosovë dhe jashtë saj. Është bartës i disa shpërblimeve: çmimi i Sallonit Pranveror të Kosovës për skulpturë (1982), çmimi i Bienales së Vizatimit në Prishtinë (1983, 1985), çmimi i Sallonit Pranveror të Kosovës në pikturë (2002) dhe çmimi i parë në konkursin për shtatoren e Agim Ramadanit në Gjiilan (2003). (Agim Rudi)

BAJRAKTARI Ibrahim (1944-2008). Gazetar. Lindi në Radavc të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, ndërsa studimet për bujqësi në Universitetin e Zagrebit. Ndoqi shkollën njëvjeçare të gazetarisë në “Vjesnik” dhe punoi në TV të Zagrebit. Ishte

korrespondent i redaksisë shqipe të TV Beogradit. Nga viti 1974 punoi në TV Prishtina (RTP), ku drejtoi emisionet për bujqësi dhe fshat. Punoi deri në korrik të vitit 1990, kur RTP-ja u mbyll me dhunë nga Serbia. (Zenun Çelaj)

BAJRAKTARI Ismet (1948-2016). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Junik, shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Gjakovë, studimet për biologji në Fakultetin e Shkencave



ISMET BAJRAKTARI

Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (1972). Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Beogradit, në drejtimin e gjenetikës, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1981). Më 1973 zgjidhet asistent në departamentin e biologjisë të FSHMN-së, ku i arrin të gjitha gradat universitare për lëndën e gjenetikës. Kontribuoi në themelimin e laboratorit të gjenetikës në seksionin e biologjisë të FSHMN-së. Publikoi punime shkencore në revista shkencore e profesionale dhe mori pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare. Për qëllime studimi në vitin 2010 qëndroi në Universitetin e Salcburgut, në laboratorin e toksikologjisë dhe të gjenetikës mjedisore. Ka qenë pjesëmarrës ose koordinator i disa projekteve shkencore. Është përkthyes i një teksti universitar dhe autor i disa teksteve të shkolave të mesme. (Fetah Halili)

BAJRAKTARI Jusuf (1948-). Historian, akademik. Lindi në Morinë të Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Ponashec, ndërsa gjimnazin në Gjakovë. Studimet për histori i mbaroi në



JUSUF BAJRAKTARI

Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1973). Po në këtë Universitet kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Një kohë punoi si mësues në shkollën fillore në Ponashec 1966-67, pastaj në Shkollën e Mesme Ekonomike, në Shkollën e Mesme Teknike dhe në gjimnazin

“Xhevdet Doda” në Prishtinë. Në periudhën 1973-1978 ishte bashkëpunëtor profesional në Sekretariatën e Kulturës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Nga viti 1978 deri më 2013 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë, ku ishte edhe drejtor dhe redaktor i revistës “Kosova” (2000-2013). Në lëvizjet pluraliste të viteve '90 ishte njëri nga themeluesit e Partisë Fshatare të Kosovës dhe nënkryetar i saj, ndërsa në zgjedhjet e organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës (1992, 1998). Në vitin 2012 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, më pas sekretar i seksionit të shkencave shoqërore dhe më 2016 anëtar i Akademisë. Deri tani ka publikuar studimin monografik “Gjakova me rrethinë në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX (1878-1912)” (1998) Ka botuar në bashkautorësi disa tekste shkollorë për shkollë fillore dhe të mesme dhe ka marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Frashër Demaj)

BAJRAKTARI Meto (1916-1943). Aktivist i lëvizjes antifashiste, pjesëtar i njësiteve partizane në Kosovë. Lindi në Mitrovicë, u arsimua në vendlindje dhe në Medresenë e Madhe në Shkup dhe më pas në Fakultetin Juridik në Beograd. Më 1937 përfshihet në radhët e organizatës së rinisë komuniste të Jugosllavisë (1937). Pas kthimit në Kosovë ishte ndër organizatorët kryesorë të demonstratave të vitit 1939 kundër rrezikut fashist dhe politikës shoviniste të Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve. Pas pushtimit fashist të Kosovës (1941), organizata e Partisë Komuniste e Prishtinës e dërgoi në njësitin partizan të Jabllanicës dhe nga shtatori i vitit 1942 në aradhën partizane të Kosovës “Zenel Ajdini”. Në tetor 1943 u bë komisar politik i aradhes partizane të Sharrit, ndërsa nga nëntori i atij viti u caktua të kryente detyra politike në terren, por u vra në një përballje me fashistët në Lubin, në shpatet e Sharrit. Më 1973 u shpall Hero i Popullit. Disa shkolla në Kosovë e mbajnë emrin e tij. (Ramiz Abdyli)

BAJRAKTARI Muharrem (1894-1989). Lindi në Ujmisht, rrethi Kukësit. Gjatë Luftës së Parë Botërore mobilizohet nga forcat austro-hungareze. Në vitin 1918 mbaron Akademinë Ushtarake në Vjenë. Në zgjedhjet e vitit 1921

A. Zogu e propozon për deputet, por ai nuk e pranoi kandidaturën. Në periudhën 1925-1927 ishte komandant i xhandarmërisë së Prefekturës së Kosovës, ndërsa më vonë avancohet në detyrën e komandantit të përgjithshëm të xhandarmërisë. Në vitin 1932 emërohet adjutant në oborrin mbretëror, më vonë e la detyrën dhe u largua në Jugosllavi, kurse në janar të vitit 1935, në bashkëpunim me Gjon Marka Gjonin nxit një kryengritje kundër qeverisë së Tiranës. Pas dështimit të kryengritjes, u largua në Kosovë, ku u përpoq të vërë kontakte me jugosllavët. Prej aty kaloi në Francë. Gjatë viteve 1940-1944 u bë lider i lëvizjes çlirimtare të Kukësit dhe i Shqipërisë Verilindore. Luftoi kundër italianëve, gjermanëve dhe komunistëve, bashkëpunoi me Abas Kupin (Legalitetin), me vëllezërit Kryeziu dhe Ballin Kombëtar. Në vitin 1946 u largua nga Shqipëria në Jugosllavi, pastaj në Greqi, në Itali dhe, së fundi, në Belgjikë. Vdiq dhe u varros në Bruksel. (Riza Sadiku)

BAJRAKTARI Musli (1951-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Suharekë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Mitrovicë, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1975). Studimet e magjistraturës i kreu në Zagreb (1980), ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1987). Në vitin 1976 u zgjodh asistent praktikant në seksionin e makinerisë të Fakultetit Teknik, më pas ligjërues, docent, profesor inordinar dhe në vitin 1998 profesor ordinar për lëndën mjetet transportuese. Ushtri funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë: ishte dekan i Fakultetit të Makinerisë në disa mandate, kryetar i Senatit të UP-së, prorektor etj. U zgjodh deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e vitit 1992 dhe 1997, zëvendësministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme (1999-2000). Është autor i dy teksteve universitare: “Mjetet transportuese” (1988), “Gjeometria deskriptive” (1985) dhe është autor dhe bashkautor i disa dispensave dhe i punimeve shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në konferenca dhe



MUSLI BAJRAKTARI

simpoziume shkencore dhe kreu një sërë projektesh për ekonominë e Kosovës. (Fejzullah Krasniqi)

BAJRAKTARI Qazim (1906-1947). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste dhe i rezistencës antikomuniste. Lindi në Astrazup të Malishevës. Komandant i njësitit vullnetar të Astrazupit nga viti 1942-1946. Në qershorin e vitit 1943, forcat e tij vullnetare u ndeshën me njësitet partizane në Rogovë dhe tek Ura e Shenjtë. Në tetorin e vitit 1943 deri në janarin e vitit 1944, me kërkesë të Xhafer Devës, bashkë me vullnetarët e tij u vendos në Tiranë dhe në Vlorë, për mbrojtjen e qeverisë profashiste nga forcat komuniste. Në nëntor 1944 iu bashkëngjit çetës së Ukë Sadikut dhe mori pjesë në ndjekjen e njësiteve partizane në Pllaçicë, Bjeshkët e Berishës deri në Suharekë. Në ndeshje me forcat partizane në fshatin Senik, u plagos. Në malet e Garaçevës, formoi çeta vullnetarësh dhe në kuadër të organizatës “Besa” të Ymer Berishës veprroi në rajonin e Llapushës e më gjerë. Mori pjesë në Kuvendin e Dobërdolit, ku u bë riorganizimi i çetave vullnetare. Në nëntorin e vitit 1945, bashkë me vëllanë Qerimin, në fillim u ngujuan në shpellë, në malin e Dubravës, e mandej në shpellën e Maçitevës dhe në bunkerin e Jezercit. U vra nga njësitë e OZN-ës në Sverkë të Gashit. (Daut Bislimi)

BAJRAKTARI Sadri (1938-). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe vaskular, profesor universiteti. Lindi në Polluzhë të Rahovecit. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa gjimnazin në



SADRI BAJRAKTARI

Prizren. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1964). Në vitin 1966 u emërua drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Rahovec. Gjatë viteve 1969-1974 ishte deputet në Kuvendin e Kosovës. Specializimin për kirurgji të përgjithshme e përfundoi në Universitetin e Zagrebit, kur mbaroi edhe studimet pasuniversitare. Më 1975 u zgjodh asistent në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës dhe më pas, me të mbrojtur disertacionin e doktoratës (1988), mori titullin docent. Mori titullin profesor ordinar në lëndën kirurgji e përgjithshme dhe luftarake në vitin 2000. Në periudhën

1991-2004 ishte kryeshf i shërbimit të kirurgjisë vaskulare në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe autor i tekstit universitar “Sëmundjet e venave” (2003). Është kryeredaktor i revistës “Kosova Journal of Surgery”, botim i Shoqatës së Kirurgëve të Kosovës. (Avdyl Krasniqi)

BAJRAKTARI Xhemajl (1938-2011). Mjek radiolog, profesor universiteti. Lindi në Radavc të Pejës. Kreu shkollën fillor në vendlindje, ndërsa të mesmen në Istog dhe Pejë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë (1964). Fillimisht punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Vishegrad, në Bosnjë e Hercegovinë dhe pas dy vjetësh u kthye në Prishtinë si kryeinspektor sanitar i Kosovës.



XHEMAJL BAJRAKTARI

Specializoi për radiologji në Zagreb më 1972, ku vijoi edhe studimet pasuniversitare. U bë radiologu i parë shqiptar në Kosovë. Po në këtë vit u emërua asistent i radiologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas ligjërues i po kësaj lënde. Qëndroi një vit në Stokholm të Suedisë për ngritje profesionale. Mbrojti tezën e doktoraturës po nga fusha e radiologjisë, ndërsa vazhdoi procesin mësimor në Fakultetin e Mjekësisë, duke marrë titullin profesor ordinar i lëndës së radiologjisë (1988). Publikoi disa punime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Pas luftës organizoi Shoqatën e Radiologëve të Kosovës dhe në këtë periudhë u mbajtën tri konferenca të radiologëve të Kosovës me pjesëmarrje ndërkombëtare. (Xhavit Bicaj)

BAJRAKU. Është institucionin politik-administrativ instaluar nga pushteti osman nga fundi i shekullit XVII, kryesisht në zonat e Malësisë së Madhe (Veriu i Shqipërisë). Në Kosovë kujtesa kolektive me këtë institucion lidhet me pjesën e Dukagjinit, sidomos me krahinën e Rugovës. Bajraku si njësi administrative bën një ndarje të re territoriale, me qëllim të ristrukturimit të formacioneve shoqërore arkaike, rregullimin fisnor që e dominonte këtë rajon. Bajraku, gjithashtu, ka sjellë një organizim të ri politik dhe administrativ brenda vetë fiseve malësore. Është udhëhequr nga bajraktari, detyra e të

cilit ka qenë të përfaqësorë bajrakun e tij, të grumbullojë taksat, të rekrutojë dhe, në rast nevojë, të furnizojë Portën me ushtarë. Instalimi i institucionit të bajraktarit ka krijuar një paralelizëm institucional me atë të kryetarit tradicional të fisit, me qëllim që të mundësohet dhe të funksionalizohet një sistem i tërthortë i sundimit. Fillimisht bajraku luante rolin e një njësie administrative-ushtarake, por me kohë fuqizohet dhe koncentron kompetenca gjithnjë e më të gjera. Bajraktari përfaqëson bajrakun e tij në Këshillin e bajraqeve (Kuvendin e fiseve), që tubohej për të marrë vendime që ishin në interes të të gjitha bajraqeve. Si formë e institucionalizuar e pushtetit, institucioni i bajrakut pushoi së vepruari pas tërheqjes së Perandorisë Osmane nga Ballkani në fillim të shekullit XX. (Anton Vukpalaj)

BAJRAMAJ Fatmire (1988-). Futbolliste. Lindi në Gurrakoc të Pejës. Kur ishte katër vjeçe, bashkë me familjen emigroi në Gjermani. Pa dijeninë e babait të saj filloi të luajë futboll në "DJK/VfL Giesenkirchen". Mori shtetësinë gjermane dhe kaloi në "FSC Mönchengladbach". Më 2004 ndërroi përsëri skuadër, tash si mesfushore në "FCR 2001 Duisburg", skuadër me të cilën do të bëhej nënkampione gjermane. Më 2007 luajti në finalen e madhe të Kupës së Gjermanisë (DFB-Pokalfinale) dhe doli e dyta me skuadrën e saj. Këtë sukses e përsëriti edhe më 2009 në Kupën e UEFA-s për Femra. Me kalimin në "Potsdam" për edicionin 2009-2010, do të bashkohet me "Corina Schröder". Më 2003, kur krijohej për herë të parë kombëtarja gjermane për femra nën 15 vjeç, Bajramaj ftohet në kombëtare, kurse më 2005 ajo do të ftohet në kombëtaren U-19. Më 2005 debutoi në skuadrën seniore kundër Skocisë. Në verën e vitit 2006 fitoi Kampionatin European me kombëtaren U-19. Me përfaqësuesen e Gjermanisë mori pjesë në Kampionatin Botëror të vitit 2007, duke u bërë kampione e botës. Në Lojërat Olimpike të vitit 2008, Bajramaj shkëlqeu sidomos në lojën kundër Japonisë. Në tetor të vitit 2009 ajo botoi autobiografinë "Hyrja ime në jetë - Nga refugjate në kampione bote". (Baki Berisha)

BAJRAMI Agim (1964-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Stagovë të Kaçanikut. Në vitin 1981 ishte njëri nga organizatorët

e demonstratave në Kaçanik dhe në qytete të tjera të Kosovës. Veprimi brenda dhe jashtë vendit. Ishte anëtar i organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK). Në vitin 1988 shkoi ushtar në armatën e ish-Jugosllavisë, ku më pas u dënua me 5 vjet burg. Pas amnistisë dhe lirimit nga burgu më 1991 emigroi në Zvicër, ku e vazhdoi aktivitetin politik në mesin e mërgimtarëve. Me shpërthimin e luftës u kthye në Kosovë dhe u rreshtua në radhët e UÇK-së, në rajonin e Drenicës. Më pas Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e ngarkoi me formimin e njësive të UÇK-së për rrethin e Kaçanikut. Ra heroikisht më 10 gusht të vitit 1998. Në qendër të qytetit të Kaçanikut i është ngritur shtatorja, ndërsa më 2016 nga presidentja e Republikës së Kosovës u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Halim Emërllahu)

BAJRAMI Agron (1967-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi arsimin filloz dhe të mesëm. Kreu studimet për grafikë në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës.



AGRON BAJRAMI

Me gazetari filloi të merret nga viti 1993, me shkrime në revistën javore "Koha", ndërsa ishte pjesë e stafit të gazetës së përditshme "Koha ditore" që nga numri i parë i saj më 1997. Fillimisht në këtë gazetë udhëhoqi rubrikën e kulturës, ndërsa në vitet e luftës 1998-1999 bënte pjesë në kolegjiun redaktues. Më pas ishte zëvendës kryeredaktor i gazetës "Koha ditore" dhe nga viti 2004 kryeredaktor i saj. Përveç editorialeve në gazetën "Koha ditore", botoi tekste autoriale në disa gazeta rajonale, si: "Vijesti" (Mali i Zi) dhe "Finance" (Slloveni) dhe në gazeta e portale të njohura, si "Frankfurter Allgemeine Zeitung", "Neue Züricher Zeitung", "The American Editor" etj. Mori pjesë në forume mediale të vendeve të ndryshme dhe është anëtar i disa organizmave profesionale. Në vitet 2006-2012 ishte kryetar i bordit të Institutit të Medies të Kosovës (IMK). Është anëtar i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK), ndërsa nga viti 2008 anëtar i bordit të Organizatës së Medieve të Europës Juglindore (SEEMO) me seli në Vjenë. (Muhamet Mavraj)

BAJRAMI Ajet (1954-2008). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Dedi të komunës së Mitrovicës. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren (1976), më pas punoi si arsimtar në Zabërxhë dhe Mitrovicë. Në shërbimin ushtarak në Zarë të Kroacisë kreu shkollën për oficerë rezervë (1977). Në shkollat e Mitrovicës mbajti mësim nga lënda e mbrojtjes popullore. Më 1992 emigroi në Gjermani, prej nga u kthye në vitin 1996. Me formimin e njësitit të parë të UÇK-së në Shalë, mori detyra me përgjegjësi. Më formimin e Brigadës 141 u emërua komandant i batalionit të dytë të kësaj brigade. Pas çlirimit të vendit u emërua komandant i Brigadës 341 "Mehë Uka" të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. (Emin Musa)

BAJRAMI Arsim (1960-). Jurist, profesor universiteti, politikan, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në fshatin Medvec të



ARSIM BAJRAMI

Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Lipjan, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare dhe disertacionin e doktoratës i mbaroi gjithashtu në Prishtinë. Në vitin 1996 u zgjodh docent dhe deri më 2004 i arriti të gjithë titujt universitarë. Pos në Universitetin e Prishtinës, ka mbajtur ligjërata edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore po në Tetovë. Në vitin 1990 ka kontribuar në grupin punues për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa në vitin 1998 ishte ekspert i jashtëm në hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ka qenë ekspert juridik në delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë (1999). Është bashkëthemelues i Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës dhe njëri ndër hartuesit e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (2008), bashkëkryesues i grupit punues për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e nga viti 2011 udhëhoqi procesin e reformës kushtetuese, pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. Pesë mandate ishte deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në periudhën (2001-2014). Gjatë viteve 2007-2010 ishte ministër i Administratës

Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa më pas ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë. Është autor i punimeve shkencore nga fusha e të drejtës kushtetuese dhe parlamentarizmit dhe i monografive: "Aspekte kushtetuese dhe politike të mëvetësisë së Kosovës" (1996), "Aktet burimore kushtetuese dhe politike të shtetësisë së Kosovës" (1996), "Modelet e demokracisë dhe sistemet krahasuese të qeverisjes" (2003) etj. dhe i teksteve universitare: "E drejta kushtetuese" (1996), "Teoria dhe praktika parlamentare" (1997), "E drejta e Kosovës në transicion" (2003), "Demokracia parlamentare" (2005), "Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës" (2011) etj. Në vitin 2012 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK-ut. (Ismet Salihu)

BAJRAMI Asllan (1955-). Gazetar. Lindi në fshatin Prapashticë të komunës së Prishtinës. Arsimin fillor e mbaroi në vendlindje, atë të mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet për letërsi shqipe i filloi në Prishtinë dhe i mbaroi në Tiranë. Punoi si gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), kryesisht në sektorët për kulturë. Pas mbylljes së RTP-së nga Serbia në vitin 1990, një kohë punoi si gazetar për Radio-Kroacinë në Zagreb, për emisionin në gjuhën shqipe dhe pastaj edhe në Radiotelevizionin Shqiptar në Tiranë, në emisionin informativ për Kosovën. Nga viti 2000 është gazetar-korrespondent i Radiotelevizionit të Kosovës në Tiranë. (Shaqir Foniqi)

BAJRAMI Ejup (1921-2000). Veteran i arsimit. Lindi në Corroticë të Preshevës. Arsimin fillor e mori në vendlindje. Mbaroi edhe kursin pedagogjik në Shkup, pastaj në Prizren dhe në Pejë dhe në vitin 1953 u diplomua mësues. Filloi studimet për histori-geografi në Akademinë Pedagogjike, por nuk i përfundoi. Si mësues punoi në Novosellë të Bujanocit, pastaj në Miratoc ku ishte edhe drejtor shkolle deri në vitin 1954. Mësues ishte edhe në Tërnoc, Tërnavë, Caravajkë dhe në Preshevë. Ishte aktivist në jetën politike dhe kulturore, kryetar i Pleqësisë së kulturës në Preshevë, anëtar i grupit të pleqnarëve në Preshevë etj. (Gafur Hyseni)

BAJRAMI Enver (1976-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe

Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Breznicë të komunës së Bujanocit. Gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1999 u përfshi në radhët e UÇK-së, në Brigadën 172 "Isa Kastrati". Në shkurt të vitit 2000 u përfshi në radhët e UÇPMB-së. Në përpjekje për të shtrirë luftën në të gjitha trojet e Luginës së Preshevës, më 21 prill 2000 ra heroikisht në luftë me forcat serbe në fshatin Gjergjevc, së bashku me Sherif Jonuzin. (Fehari Ramadani)

BAJRAMI Fatmir (1949-). Kameraman. Lindi në Prishtinë. Ishte njëri ndër kameramanët e gjeneratës së viteve shtatëdhjetë, të cilët sollën risi në punën televizive të asaj kohe. Studimet për kamerë i kreu në Paris (CLCF), kurse në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP) ia filloi punës më 1974, që nga themelimi i tij. Pas mbylljes së dhunshme të RTP-së, pas vitit 1990, punoi si reporter-kameraman nga Kosova për disa shtëpi televizive, si CNN, ZDF, ARD, Francë 2 etj. (Nehat Islami)

BAJRAMI Gani (1953-). Gazetar. Lindi në Mirofc, komuna e Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Fushë-Kosovë, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës. Punoi gazetar, komentator e redaktor në periudhën 1978-2002 në gazetën "Rilindja" në Prishtinë, ndërsa një kohë ishte edhe ndihmës i kryeredaktorit dhe zëvendëskryeredaktor. Në periudhën 2002-2009 punoi redaktor në gazetën "Kosova sot". Është autor i librave publicistikë "Qëndresë përballë stuhive" (1997) dhe "Qëndresa dinjitoze" (2002). Është autor i një sërë shkrimesh analitike-komentuese për çështje të ndryshme shoqërore e politike, autor recensionesh për libra dhe shfaqje teatrore, i eseve dhe vështrimeve për probleme të kulturës dhe të artit. Është autor edhe i disa dramatizimeve, të cilat janë vënë në skenën e Teatrit të Fushë-Kosovës, si dhe regjisor i disa shfaqjeve në këtë teatër. Është redaktor në agjencinë e lajmeve "Kosova-Live" në Prishtinë. (Shefqet Rexhepi)

BAJRAMI Hakif (1943-). Historian. Lindi në Ballofc të Podujevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Podujevë, studimet universitare në degën e historisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë (1969). Nga viti 1970 deri më 1975 punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Podujevës dhe më pas të Prishtinës. Studimet pauniversitare i kreu në Fakultetin Filozofik të



HAKIF BAJRAMI

Universitetit të Prishtinës, ku më pas mbrojtë edhe disertacionin e doktoratës (1979). Në Institutin e Historisë punoi nga viti 1975 deri më 1981, kur u zgjodh drejtor i Arkivit të Kosovës, detyrë që e kreu për dy mandate. Ka botuar dhjetëra vepra shkencore dhe publicistike, monografi dhe përmbledhje dokumentesh: "Rrethanat shoqërore politike në Kosovë 1918-1941" (1981), "Aradhja partizane e Shalës" (1981), "Partia Komuniste e Jugosllavisë në Kosovë 1919-1941" (1983), "Libri i Bardhë" (1992), "Tragedia e Tivarit" (1993), "Bedri Pejani 1885-1946" (1994), "Dokumente gjermane për historinë shqiptare 1941-1944" (1998), "Dosja Demaçi" (2003), "Komiteti 'Mbrojtja Kombëtare e Kosovës' dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1941" (2008) etj. Mori pjesë në tubime të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe publikoi një sërë studimesh dhe kontributesh historiografike në gazeta e revista të ndryshme. (Haki Kasumi)

BAJRAMI Mexhid (1942-). Piktur. Lindi në Llojan të Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Normalen në Shkup, ku kreu dhe studimet në Akademinë Pedagogjike, dega e artit figurativ (1964). Nga vitit 1971 punoi në redaksinë e revistave të "Rilindjes" si redaktor teknik dhe ilustrator. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1971 dhe mori pjesë në sallonet dhe ekspozitat tradicionale të organizuara nga kjo shoqatë. Krijimtaria artistike e tij filloi nga viti 1966, me pjesëmarrje në ekspozitën e artistëve figurativë jugosllavë në Karlovc. Mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta, si në Kumanovë (1968), Beograd (1969), Shkup (1969), Ulqin (1969), Manastir, Prishtinë etj. Lufta e Kosovës i shkaktoi dëme të mëdha krijimtarisë së tij, sepse policia dhe paramilitarët serbë ia dogjën një numër të madh pikturash, vizatimesh e skicash. (Iilir Muharremi)

BAJRAMI Muharrem (1950-). Mjek, infektolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Hajkobillë të Prishtinës, shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Prishtinë, ku kreu edhe

Fakultetin e Mjekësisë (1974). Pas diplomimit u pranua asistent i lëndës së farmakologjisë. Më pas u punësua si mjek në Drenas, ndërsa në vitin 1977 filloi specializimin në Klinikën Infektive të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, kurse vitin e fundit e kreu në Zagreb (1980). Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit (1986), ndërsa disertacionin nga fusha e infektologjisë e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1988). Në vitin 1977 u zgjodh asistent praktikant, më 1994 asistent i rregullt, kurse në vitin 2002 profesor i rregullt i lëndës sëmundjet ngjitëse. Pas vitit 2000 ishte drejtor i Klinikës Infektive dhe anëtar i disa komiteteve nacionale. Ka botuar shumë punime profesionale-shkencore dhe ka marrë pjesë në disa kongrese dhe shumë tubime shkencore brenda dhe jashtë shtetit. Punon në Klinikën për Sëmundje Ngjitëse në Prishtinë. (Shemsedin Dreshaj)

BAJRAMI Raif (1936-). Mësimdhënës, jurist. Ka lindur në Corroticë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Preshevë, ndërsa të mesmen në Normalen e Prishtinës. Shkollën e Lartë Pedagogjike e përfundoi në Zrenjanin të Vojvodinës. Ka punuar arsimtar i matematikës-fizikës në Raincë të Preshevës, ndërsa nga viti 1961, pas themelimit të paraleles së Gjinnazit të Vranjës “Bora Stanković” në Preshevë për 10 vjet ka punuar si arsimtar i fizikës dhe i matematikës në këtë gjinnaz. Ka qenë ndër arsimtarët e paktë shqiptarë që mbanin mësim shqip në këtë shkollë. Më pas është zgjedhur drejtor i shkollës më të madhe tetëvjeçare në Preshevë, ku ka punuar për një mandat e gjysmë. Paralelisht i ka mbaruar studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë dhe nga viti 1976 ka filluar punën si sekretar në Fakultetin Filozofik, më vonë Filologjik të Universitetit të Prishtinës. (Gafur Hyseni)

BAJRAMI Vehbi (1964-). Gazetar. Lindi në fshatin Depcë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Preshevë, ndërkaq studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Si student punoi në gazetën e studentëve “Bota e re” në Prishtinë. Më 1990 emigroi në SHBA, ku më pas filloi të punojë në gazetën shqiptaro-amerikane “Illyria”, që botohet në Nju-Jork, në fillim si gazetar e më pas kryeredaktor i saj. Nga viti 2006 është botues i kësaj gazete. Gjatë këtyre viteve shkroi

për personalitete dhe familje shqiptare në Amerikë. Shkrimet për mërgatën shqiptare në SHBA i përmbodhi në librin “Shqiptarët e Amerikës”. Më 2011 në Uashington botoi në anglisht librin “Vizita ime në Tokën e Shenjtë”. Gjatë viteve 2005-2006 ishte shëf i seksionit shqip të Radios “Zëri i Amerikës”. Jeton në Nju-Jork (SHBA). (Zenun Çelaj)

BAJRAMI Zeqir (1916-1977). Gjeograf, profesor, pedagog, edukator. Lindi në Tupallë të Jabllanicës, sot komuna e Medvegjës. Shkollën fillore e mbaroi në Medvegjë, Medresenë e Madhe në Shkup, ndërsa u diplomua në Universitetin e Zagrebit (1943). Deri në fund të viteve ‘60 punoi profesor i gjeografisë në shkollat e mesme të Prishtinës. Drejtonte edhe kurset verore për kualifikimin e mësuesve në disa qendra të Kosovës. Në vitin 1969 zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në seksionin e gjeografisë, duke mbajtur mësim nga disa lëndë. La një trashëgimi të pasur në fushën e arsimit dhe të dijes: shumë punime, vështrime dhe tekste shkollore. Përktheu dhe përshtati tekste profesionale-shkencore dhe didaktike, duke dhënë kontribut në pasurimin e terminologjisë gjeografike. (Hivzi Islami)

BAJRAQET E KOSOVËS. Në traditë shqiptare të Kosovës, si edhe në viset e tjera shqiptare, bajraku është organizim fisnor patriarkal. Në fillim bajraku përfshinte fisin e tërë, të përbërë prej “vllaznive”, që rridhnin nga “pema e gjakut” prej një babe ose ishin të dyndur bashkë me të tjerët të të njëjtit fis, që i gjetën në vendin e migrimin. Në krye të bajrakut, udhëheqës me të drejtë trashëgimie deri në raste të veçanta, në rrethana lufte dhe paqe ishte bajraktari. Ai, bashkë me “Këshillin e pleqve”, që përfaqësohej nga kryefamiljarë të zgjedhur në kuvend fisi ose fisesh, drejtonte fisin, përkatësisht territorin ku bënë pjesë të organizuar më shumë se një fis për ligjënie në paqe, që nënkupton tërë rregullat e sjelljes, të punës dhe të jetës brenda fisit, ose të territorit që “mbulon” ai bajrak; pastaj organizimin e ushtrisë për luftë, duke ruajtur të drejtën dhe obligimin e bashkorganizimit në nivel më të gjerë. Ndër bajraqtë në Kosovë po përmendim: Bajraku i Krasniqes (Radavc-Podgur, Rrafsh i Dukagjinit), Bajraku i Gashit (Uçë-Podgur, Rrafsh i Dukagjinit), Bajraku i Koshutanit (fisi Kelmend, Koshutan-Rugovë),

Bajraku i Llaushës (Drenicë), Bajraku i Astrazubit (Llapushë), Bajraku i Lugut të Baranit (Rrafsh i Dukagjinit), Bajraku i Opojës etj. Në Kosovë, për dallim nga bajraktari i fisit, gjithëherë krushqve në dasmë iu prihej me bajrak (me flamur, por jo me bajrak të luftës) nga bajraktari, i cili është dashur të jetë nipi i burrëruar në mesin e nipërve (lisi i qumështit - element avunkulati) në shtëpinë e dhëndrit, ku organizohet dasma, e në mungesë të tyre është zgjedhur dikush nga pjesëtarët e fisit. (Ukë Xhemaj)

BAJRI Ilir (1969-). Kompozitor dhe pianist xhazi. Lindi në Prishtinë. Pas shkollës fillore, kreu Shkollën e Mesme të Muzikës po në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Arteve, dega e muzikës, drejtimi teorik-pedagogjik. Është ndër të rrallët dhe të suksesshmit që i është përkushtuar gjinisë së xhaz-muzikës ndër ne, si kompozitor dhe xhaz-pianist. Ka marrë pjesë në një varg koncertesh e festivalesh të xhaz-muzikës. Kompozimet e tij, si “Vijëzimi”, “Përtej”, “I-turn-U” etj., janë realizuar me sukses jo vetëm në Kosovë, por edhe në Itali (1995), Shqipëri (Ditët e Muzikës së Re Shqiptare, 1999) dhe gjetiu. I është qasur dhe ka realizuar me sukses edhe kompozime elektronike me elemente xhazi dhe muzikë për teatër e film. Është themelues dhe drejtues i Festivalit të Xhaz-muzikës në Kosovë, që organizohet vite me radhë në Prishtinë dhe ku marrin pjesë kompozitorë, instrumentistë e xhaz-grupe dhe xhaz-ansamble nga vende të ndryshme. (Indira Çipa)

BAJRI Mehdi (1944-2013). Kompozitor i muzikës në frymën popullore dhe i asaj të lehtë. Lindi në Pejë, ku mori arsimin fillor. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, ndërsa shkollimin e lartë e filloi në Beograd dhe e mbaroi në Prishtinë. Fillimisht ishte pedagog i muzikës në Normalen e Pejës dhe në disa shkolla të tjera. Më 1973 filloi punën si bashkëpunëtor i muzikës në Televizionin e Prishtinës (TVP), ku më pas u bë redaktor i programit muzikor. Këtë detyrë e kreu edhe pas vitit 1999. Në TVP kontribuoi në afirmimin e muzikës shqiptare në të gjitha zhanret. Punoi edhe në terren për zbulimin e talentëve të reja. Kontribuoi në themelimin e produksionit të kasetave në kuadër të TVP-së. Më 1981, për shkaqe politike u largua nga detyra e redaktorit. Në vitet

'90 themeloi produksionin muzikor privat “Pro Ars”, nga i cili dolën shumë albume muzikore. Zhvilloi edhe karrierën e kompozimit. Mori pjesë në të gjitha festivalet e rëndësishme në Kosovë, veçanërisht në “Akordet e Kosovës”, ku tri herë fitoi i “Okarinën e artë” (1978, 1981, 1985). Ndër këngët e tij më të suksesshme janë: “Pejë o lule e Dukagjinit”, “Peja ime”, “Poshtë tek manat”, “Lumi” etj. (Xhevdet Gashi)

BAJRON Xhenet (Janet Byron) (1935-). Gjuhëtare amerikane, albanologe. Studiuesja e parë e huaj që u mor me politikën e planifikimit për standardizimin e shqipes pas Luftës së Dytë



XHENET BAJRON

Botërore. Në vitet '70 të shek. XX botoi disa studime sociolinguistike mbi shqipen standarde. Më 1973 botoi studimin “Përzgjedhja dhe vlerësimi i alternativave në standardizimin e gjuhës shqipe” (Selection and evaluation of alternatives in Albanian language standardization), pas të cilit, më 1976 botoi librin “Përzgjedhja midis alternativave në standardizimin e gjuhës: rasti i Shqipërisë (Selection among alternatives in language standardization: The case of Albanian), i ribotuar më 2010, i botuar shqip më 2012 me titull “Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera”. Më pas botoi “Planifikimi gjuhësor në Shqipëri dhe në Jugosllavinë shqipfolëse” (1979) (Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia) dhe “Vështrim mbi arritjet e planifikimit gjuhësor ndër shqiptarët e Jugosllavisë” (1985) (An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia). Në librin e vitit 1976 solli argumente që tregojnë se përse “toskërishtja përbën bërthamën fillestare të gjuhës standarde shqipe”. Për trajtimin sociolinguistik të procesit të standardizimit të shqipes ajo u mbështet jo vetëm në literaturën dhe njohjet e saj për shqipen, por edhe në konceptet e autorëve si P. S. Rej, E. Haugen, V. Tauli dhe J. V. Neustupný. Lidhur me tezat e saj ka pasur diskutime shkencore. (Shkumbin Munishi)

BAKALLI Mahmut (1936-2006). Politikan dhe funksionar i lartë komunist në Kosovë. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të



MAHMUT BAKALLI

mesëm i kreu në Prizren dhe Mitrovicë, Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd (1967). Punoi si mësimdhënës i sociologjisë në Universitetin e Prishtinës. Karrierën politike e filloi në vitet '60, si kryetar i Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve (LK) të Prishtinës, pastaj edhe kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës (1971-1981), anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror (KQ) të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ) dhe deputet në Parlamentin Federativ të Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe u angazhua për zhvillimin politik, ekonomik e kulturor të Kosovës dhe për forcimin e autonomisë së saj. Mbështeti dhe u angazhua për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare dhe në veçanti të Kosovës si njësite barabartë në Federatën Jugosllave. Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë nuk u pajtua me qëndrimet e Kryesisë së KQ të LKJ-së rreth vlerësimit dhe zbatimit të strategjisë dhe masave kundër kërkesave të demonstruesve, për çka detyrohet të japë dorëheqje nga të gjitha funksionet politike e shtetërore. Njëkohësisht distancohet nga programet dhe aktivitetet për zbatimin e strategjisë së LKJ-së, sidomos në procesin e diferencimit ideopolitik pas ngjarjeve në Kosovë. Pas largimit nga posti i kryetarit të KK të LK të Kosovës, vazhdoi punën si zyrtar në sektorin administrativ, pa ushtruar ndonjë funksion me rëndësi. Në vitet '90 mori pjesë aktive në jetën dhe zhvillimet politike dhe publike brenda dhe jashtë Kosovës. Në periudhën 2001-2004 ishte deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe këshilltar politik i kryeministrave Ramush Haradinaj dhe Bajram Kosumi. (Adem Murati).

BAKALLI Qazim (1895-1981). Klerik bektashian (baba), mësues dhe atdhetar. Lindi në Gjakovë, mësimet e para i mori në ruzhdien e qytetit dhe në vitin 1909 vazhdoi në "Darul Mualiminë" në Shkup. Punoi si mësues i gjuhës shqipe dhe veprimtar i edukimit kombëtar. Përktheu disa vepra nga turqishtja në shqip. Në vitet 1915-1918 punoi si mësues në shkollën shqipe në Gjakovë. Në vitin 1918 u detyrua të emigronte në Shqipëri, ku shërbeu si mësues

në Lumë. Ishte edhe nëpunës. Më vonë hyri në tarikatit bektashi në Fushë-Krujë. Shërbeu si dervish në teqenë e Elbasanit, si baba në teqenë Harabati të Tetovës. Në vitin 1947 Baba Qazim Bakalli kthehet në Gjakovë, ku shërbeu në Teqenë Bektashiane të qytetit. (Jusuf Meqa)

BAKALLI Remzi (1944-2007). Agronom, veterinar, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në Prizren, shkollën e mesme bujqësore në Kralëvë (Serbi). Studimet e shkencave bujqësore, drejtimi i blegtorisë, i përfundoi në Universitetin e Beogradit, në Fakultetin e Bujqësisë në Zemun, studimet pauniversitare në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Zagrebit (1971), kurse



REMZI BAKALLI

disertacionin e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Veterinarisë po në Universitetin e Zagrebit (1975). U punësua si bashkëpunëtor shkencor i biokimisë dhe i të ushqyerit të kafshëve në Institutin e Blegtorisë dhe të Veterinarisë në Prishtinë (1970). Kreu specializimin në lëmin e të ushqyerit të kafshëve në Gainesville, në Universitetin e Floridës dhe në Universitetin e Xhorxhias, në Athena, SHBA (1987). U zgjodh docent në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës, ku më 1988 mori titullin profesor ordinar. Ishte dekan i Fakultetit të Bujqësisë (1977-1979), ndërsa më 1986 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe anëtar i rregullt në vitin 1991. Pas futjes së masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga pushteti serb, ishte ndër profesorët e parë që u dëbua nga puna. Për shkak të trysnisë së vazhdueshme që ushtronte pushteti i dhunshëm serb mbi të dhe familjen e tij, R. Bakalli në vitin 1992 u detyra të largohet nga Kosova dhe që atëherë ka jetuar dhe vepruar në Universitetin e Xhorxhias, në Athena të SHBA-së. Në fillim punoi si imunologjist në kolegjin e mjekësisë veterinarë, e nga viti 1994 koordinator shkencor në departamentin e shkencave të shpendarisë të Universitetit të Xhorxhias, duke vazhduar bashkëpunimin me Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë në projekte, pajisje të laboratorëve me mjete, me përgatitjen e punimeve shkencore dhe avancimin e kuadrit mësimor të fakultetit. R. Bakalli ishte redaktor i

revistës “Bioteknika”, revistë shkencore e shoqatës së inxhinierëve dhe teknikëve të Kosovës dhe anëtar i bordit të revistës “Acta Biologiae et Medicinae Experimentalis”. Publikoi pesë libra nga fusha e të ushqyerit të kafshëve dhe nga toksikologjia dhe një sërë punimesh shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare. U nderua me çmime dhe mirënjohje. Vdiq dhe u varros në Athena, SHBA. (Latif Susuri)

BAKER (BACKER) Berit (1947-1993). Antropologe norvegjeze. Nga puna hulumtuese në terren në vitet 1974-75, që e realizoi në Isniq të Kosovës, në vitin 1979 mbrojti titullin e



BERIT BAKER

magjistrit në antropologji në Universitetin e Oslo. Punoi si antropologe, përkthyesë e dokumenteve nga gjuha shqipe si edhe këshilltare për emigrantët shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia në vitet '80. Punoi për organizatën

Amnesty International lidhur me të burgosurit politikë të Kosovës. Themeloi Komitetin e Helsinkit në Prishtinë më 1989 dhe në Tiranë më 1991. Kontribuoi në organizimin e diasporës së shqiptarëve të Kosovës, si edhe e themeloi një qendër informative për kosovarët e shpërngulur në Norvegji. Vepra kryesore e saj është teza e magistraturës “Prapa mureve të gurta” (Behind the Stone Walls), e botuar nga “Dukagjini Balkan Books” më 2003. Është autore edhe disa artikujve për shoqërinë tradicionale shqiptare në revista ndërkombëtare, si dhe e raporteve për Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit gjatë periudhës 1983-1990. Ishte bashkautore e dy filmave dokumentarë për traditat shqiptare në Kosovë dhe në Shqipërinë e Veriut, që u shfaqën në televizionet publike në Suedi (1977) dhe në Angli (1991). U vra në Norvegji nga një refugjat kosovar me probleme mendore. (Arbnora Dushi)

BAKI Enver (1943-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin tetëvjeçar, gjimnazin dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në vendlindje. Në fillim punoi si gazetar dhe redaktor në programin për fëmijë të Radio Prishtinës (1962-1969). Në vitet 1969-1992 ishte kryeredaktor i gazetës “Tan”. Librin e parë, “Çelësat” e botoi në vitin 1972. Më pas vijnë librat e botuar: “Babai i lumtur”

(1974), “Pesë vëllezërit” (1988). Botoi dhe librat: “Luhaja”, “Ura e Gurit”, “Përjetimet e Canit”, “Rrugët e vjetra të Prishtinës”, “Fëmijët e lagjes Katër Llulla”, “Tregimet fetare të Adem Agës” etj. Tregimet e tij u përkthyen shqip dhe në gjuhë të tjera. (Irfan Morina)

BAKIJA-GUNGA Drita (1943-). Historiane, mësimdhënëse. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Gjakovë, ndërsa studimet për histori i filloi në Universitetin e Sarajevës dhe i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Në UP kreu edhe studimet pasuniversitare më 1977, ndërsa më 1982 mbrojti tezën e doktoratës. Punoi si mësimdhënëse në gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë dhe në shkollën fillore “Elena Gjika” në Prishtinë, për ta vazhduar punën më pas në Institutin e Historisë në Prishtinë (1975-2009). Gjatë kësaj periudhe ishte mësimdhënëse e angazhuar edhe në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të UP-së. Ishte një nga themelueset e Shoqatës së Gruas (mars, 1990) dhe më vonë të Forumit të Gruas të LDK-së dhe anëtare e Kryesisë së saj (1995-2000), ku drejtoi komisionin për shkencë në kuadër të këtij forumi. Me kumtesa dhe refereate mori pjesë në konferenca dhe simpoziume të ndryshme shkencore në vend dhe jashtë. Botoi punime shkencore dhe publicistike në revista të ndryshme. Është autore e studimit monografik “Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist 1945-1978” (1984). (Sulltane Ukaj).

BALA Behxhet (1964-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Zabërxhë të Mitrovicës. Gjatë viteve '90 ishte aktiv në organizimin lokal të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Me daljen publike të UÇK-së në Shalë bëhet njëri nga themeluesit e UÇK-së në Shalë të Bajgorës. Ishte pjesë e njësitit të parë nga 18 prilli i vitit 1998 dhe njëri ndër organizatorët dhe udhëheqësit e Brigadës 141 “Mehë Uka”. Në qershor të vitit 1998 u emërua udhëheqës i furnizimeve dhe ndihmëskomandant për logjistikë në këtë brigadë. Më pas u emërua ndihmëskomandant për logjistikë në Zonën Operative të Shalës. Pas përfundimit të luftës kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrotjëse të Kosovës. (Emin Musa)

BALA Qamil (1878-1933). Veprimtar i arsimit, Mësues i Popullit. Lindi në Gjilan.

Shkollën fillore dhe qytetëse turke i kreu në Prishtinë, gjimnazin në Manastir, Shkollën e Lartë Normale në Stamboll. Filloi punë në shkollën turke në Gjilan, por për shkaqe politike u detyrua ta braktisë vendlindjen. Ishte mësimdhënës gjimnazi në Janinë, Manastir dhe në Selanik, pastaj drejtor gjimnazi në Jerusalem, drejtor i përgjithshëm i arsimit në Bagdad, inspektor i përgjithshëm i arsimit në Damask. Ishte kandidat për drejtor në Normalen e Elbasanit, por xhonturqit e ndaluan në Selanik dhe nuk e lejuan të shkonte në Elbasan. Në Shqipëri u kthye në vitin 1920. Fillimisht punoi si mësues, pastaj inspektor i arsimit në Qarkun e Elbasanit. Mori pjesë në Kongresin Arsimor të Tiranës (1922) dhe ishte drejtor i Medresesë së Lartë në Tiranë. Për shkaqe politike u detyrua ta braktisë vendin dhe të qëndrojë në Berlin, në Vjenë dhe në Gjenevë, ku u mor me veprimtari atdhetare. Në Shqipëri rikthehet më 1930. Emërohet drejtor i konviktit dhe i normales për vajza “Naim Frashëri” në Tiranë. Ishte anëtar i Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” dhe deputet në Parlamentin Shqiptar (1922-1924). Si publicist, shkroi për çështje pedagogjike dhe politike. U shqua për organizimin e arsimit kombëtar, laik dhe demokratik, për arsimin dhe emancipimin e gruas dhe për arsimin e të rriturve. (Hajrullah Koliqi)

BALADA. Lloj i krijimtarisë poetike popullore, me përmbajtje shumështrësore dhe me origjinë të lashtë mitologjike, që sintetizon vlerat e shumë llojeve të tjera poetike. Që nga zanafilla është krijuar me të gjithë përbërësit që e karakterizojnë sinkretizmin folklorik: tekstin, muzikën dhe vallen. Brenda strukturës së saj përfshihen edhe përbërësit semantikë, që e karakterizojnë botën reale dhe joreale, legjendën dhe realitetin, mitin dhe çmitizimin. Si këngë përcillet edhe me vegla muzikore aerofone. Emërtimi vjen nga gjuhët neolatine dhe ka domethënie këngë e vallëzimit. Ishin këngë të truverëve dhe të trubadurëve mesjetarë. Në emërtimet tona popullore balada quhet “kangë e moçme” apo “kangë e dhimshme”. Në aspektin përmbajtësor, baladat janë mitologjike, në të cilat trajtohen konflikte të thella etike, siç është motivi i murimit (“Ura e Fshejtë” apo “Rozafati”), motivi i vëllait të vdekur që ngrihet nga varri për ta përmbushur besën e dhënë (“Konstantini e

Garentina” ose “Halil Garria”); pastaj baladat për metamorfozën e dashnorëve të pafat etj. Janë të njohura edhe baladat historike, midis të cilave shquhen ato të arbëreshëve të Italisë për periudhën e Skënderbeut (të Motit të Madh). Baladat e këtilla janë krijuar edhe gjatë periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (“N’ Fushë t’Kosovës lidhet jezeri” etj.), si edhe për ngjarjet e ndryshme, deri në ditët tona. Kemi një numër baladash me motive realiste me përmbajtje erotike (“Në dërrasë të vekut kush po kjanë”, “Rrushja e Rexhës n’fund t’livadhit”), pastaj me tematikë sociale, siç janë baladat e nizamëve (“Mbeç ore shokë, mbeç”), ato të mërgimit dhe baladat e tjera për situata të ndryshme të konflikteve me pasoja tragjike. Baladat te ne janë botuar në të gjitha vëllimet e deritashme të botimeve folklorike, ose si botime të veçanta. (Sadri Fetiu)

BALAJ Artan (1977-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Prishtinë, ku kreu dhe Fakultetin e Arteve, drejtimi i pikturës (2004). Një kohë punoi si asistent i anatomisë plastike në një kolegji privat në Prishtinë ndërsa, më pas, në vitet 2010-2012, ishte drejtues dhe koordinator në disa projekte nga fusha e marketingut dhe multimedias. Nga viti 2012 punon në Solutions Manpower Group në Bruksel (Belgjikë). Merr pjesë në ekspozita kolektive në Kosovë, Belgjikë dhe në vende të tjera. Veçohet me ekspozitat personale në Prishtinë (2005), në Aiud të Rumanisë (2007), në Nowy Targ të Polonisë (2007), në Tecate të Meksikos (2009), në Belforte del Chienti të Italisë (2010), pastaj në Utreht të Holandës (2014) etj. Në veprat e tij është e pranishme shprehja impulsive me forma reale dhe abstrakte, ku komponentet figurative në strukturën pikturore e krijojnë ndjesinë estetike. Aktualisht jeton dhe vepron në Anvers të Belgjikës. (Rexhep Goçi)

BALAJ Idriz (1971-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Gllarevë të Klinës. Në vitin 1991, për t’i ikur shërbimit ushtarak, iku në Kroaci, ku u inkuadrua në Mbrotjtjen Territoriale të Kroacisë. Më pas u bë pjesëtar i forcave të rregullta ushtarake kroate. Në prill të vitit 1998 u kthye në Kosovë dhe iu bashku UÇK-së, fillimisht në Jabllanicë, pastaj në Glllogjan. Një muaj më vonë u ngarkua të formojë njësitin special për Zonën Operative

të Dukagjinit “Shqiponjat e zeza”. Njësitë mori pjesë në aksione të rëndësishme kundër forcave serbe, në mbrojtje të popullatës civile ose në operacione strategjike të UÇK-së. Pas përfundimit të luftës, më 2002, Gjykata e Qarkut në Pejë, me gjykatës të UNMIK-ut ngriti aktakuzë ndaj I. Balajt për krime lufte dhe u dënua me 15 vjet heqje liri. Në vitin 2005 Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte në Hagë ngriti aktakuzë për krime lufte për “Grupin e Dukagjinit”, ku bënte pjesë edhe I. Balaj. Në vitin 2008 Gjykata e Hagës e liroi si të pafajshëm, më 2010 e ktheu në rigjykim dhe më 2012 sërish u shpall i pafajshëm. (Bedri Muhadri)

BALAZHI Zeni (1975-). Dizajner. Lindi në Kërçovë të Maqedonisë. U diplomua në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë (1998). Nga viti 2001 punoi si kurator në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë, ndërsa nga viti 2013 u angazhua bashkëpunëtor i jashtëm për mësimdhënie të artit konceptual dhe mediet e reja në Fakultetin e Arteve në Prishtinë dhe në Universitetin e Tetovës. Hapi dy ekspozita personale në Prishtinë (Pallati i Shtypit, Galeria e Fakultetit të Arkitekturës “Modelarium”), pastaj në Shkup dhe në Kërçovë. Është autor i logove, medaljoneve dhe pullave postare. U dekorua nga presidenti i Republikës së Shqipërisë për logon “100 Vjet Pavarësi” (2012). Disenjoji me sukses medaljen humanitare “Nënë Tereza”, medaljen “Trofeu i Presidentit” etj. Ishte drejtor artistik dhe scenograf i disa shfaqjeve teatrore, i filmave artistikë dhe dokumentarë. Shkruan edhe vështrime kritike nga lëmi i arteve pamore. (Blerim Luzha)

BALDAÇI Antonio (Baldacci) (1867-1950). Studiues, botanist dhe gjeograf italian. Që nga fundi i shek. XIX filloi të bëjë kërkime në Ballkan (në Dalmaci, Malin e Zi, Shqipëri dhe Greqi). Botoi artikuj dhe libra lidhur me Shqipërinë për çështje ekonomike, politike, gjeografike, botanike dhe etnografike. Ndër to kryesore është vepra “Studime të posaçme shqiptare” në tre vëllime (“Studi special albanes”, 1932-1937). A. Baldaçi tregoi interes të madh edhe për gjeografinë. Për aspekte gjeografike botoi vëllimin “Itinerare shqiptare (Itinerari albanesi, 1892-1902), pastaj “Harta të reja të Shqipërisë” (Nuove carte dell’Albania, 1914), “Shqipëria” (Albania, 1929). Studimet e tij për Shqipërinë dhe vise të tjera ballkanike

përmbajnë të dhëna me vlerë për gjendjen ekonomiko-shoqërore dhe demografike të Shqipërisë dhe lidhen edhe me interesimin në rritje të shtetit italian për bregun lindor të Adriatikut. (Alban Dobruna)

BALETI I KOSOVËS. Ansambël i themeluar në vitin 1972 në kuadër të Tetarit Popullor Krahnior në Prishtinë. Balerinët e gjeneratës së parë të këtij ansambli, 26 syresh, u shkolluan



SHFAQJE E TRUPËS SË BALETIT TË KOSOVËS

në Shkollën e Mesme të Baletit në Shkup. Prej tyre, 19 ishin meshkuj, kurse 6 femra. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm, shumica u kthyen në Prishtinë dhe, në kuadër të Teatrit Popullor Krahnior, u formua Ansambli i Baletit. Disa nga balerinët e parë të gjeneratës së parë të këtij ansambli janë: A. Brahimaj, Rr. Selca, E. Nikçi, Sh. Hoxha, E. Mulla, S. Kiçe, G. Loshi, J. Beqiraj, H. Podrimçaku, Rr. Bajrami, Rr. Metaj, I. Bajraktari, G. Shala, S. Domniku, Sh. Shabanaj, E. Berisha etj. Udhëheqës i Ansambllit të Baletit u zgjodh Abdurrahman Nokshiqi-Abi, një nga përfaqësuesit më të njohur të baletit kosovar. Më vonë këtij ansambli iu bashkuan edhe 5 balerina nga Shkupi e, gjithashtu, pjesë e kësaj trupe u bënë edhe balerinat kosovare: N. Meha Selca, S. Spahiu-Shkreli si dhe dy balerinët E. Elshani dhe J. Berisha. Megjithëse baleti kosovar dëshmon për shenja të suksesit dhe të pjekurisë artistike qysh në vitet ‘70, në ansambël u ndie mungesa e balerinave femra. Kjo mungesë u arrit të plotësohet me marrëveshjet e bashkëpunimit që u bënë me trupat e tjera të baletit, për angazhim periodik të balerinave nga ish-Jugosllavia dhe nga vende të ndryshme të Europës. Në vitet ‘70 dhe ‘80 Ansambli i Baletit arriti të nxirrte në skenë shfaqje mjaft të mëdha nga kompozitorë të

huaj e shqiptarë, si: Çajkovski, Ravel, Shtraus, Gershvin, dhe R. Mulliqi, R. Dhomi, P. Jakova, A. Koci, G. Zajmi, B. Shehu etj. Ndër inskenimet e suksesshme u konsideruan shfaqjet “Sokoli e Mirusha”, “Halili e Hajria”, “Bolero”, “Legjenda mbi ngadhënjimin”, “Romeo e Zhuljeta”, “Kënga e Rexhës”, “Besa”, “Don Kishoti”, “E bukura More” etj. Me disa nga këto shfaqje Ansambli i Baletit u paraqit me sukses në skenat e ish-Jugosllavisë dhe në festivale të ndryshme, si në Festivalin ndërkombëtarë “Bienalet e baletit” në Lubjanë, në Festivalin “Lojërat verore të Dubrovnikut” etj. Në vitin 1991, balerinët kosovarë u larguan me dhunë nga Teatri dhe, pas një zbrazëtie dhjetëvjeçare të aktivitetit artistik, pas luftës, Ahmet Brahimaj, që ishte drejtues ansambli që nga viti 1985, së bashku me kolegët e tij, në kuadër të Shkollës së Mesme të Muzikës në Prishtinë, arrin të hapë Shkollën e Mesme të Baletit. Në vitin 2001 doli në skenë gjenerata e parë e balerinëve të kësaj shkolle, të cilët nën koreografinë e O. Viaud dhe me muzikë të J. N. Françoise inskenon me sukses shfaqjen “Fyelltari”. Kjo shfaqje paraqet rikthimin e baletit në skenën e Teatri Kombëtar të Kosovës. Në vitin 2005 u diplomua klasa e A. Brahimajt, e cila është bërthama e gjeneratës së re të Baletit të Kosovës, në mesin e të cilëve shquhen S. Kajtazi, B. Murtezi, L. Ademi, V. Llugiqi, L. Rexhepi, B. Neziri, J. Musolli etj. Në fazën e rithemelimit dhe të rikonsolidimit, Baleti i Kosovës ka bashkëpunuar me sukses me koreografët nga Shqipëria, si Gj. Prevazi, E. Cefa, A. Ibërshimi etj. Në këtë periudhë, Baleti i Kosovës përgatiti me sukses shfaqjen “Bukuroshja e fjetur”, me muzikën e P. I. Çajkovskit. Baleti i Kosovës zhvillon bashkëpunim me koreografë dhe trupa të baletit nga shtete të ndryshme të Europës dhe më gjerë, duke arritur nivel të mirë organizativ, teknik dhe artistik. (Besim Rexhaj)

BALIQI Bekim (1977-). Politolog, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për histori i filloi në Universitetin e Prishtinës (UP), më pastaj studioi në Universitetin e Vjenës për shkencë politike, shkencë të komunikimit masiv, filozofi, antropologji dhe histori të Europës Juglindore. Studimet e doktoratës i mbaroi në Institutin e Shkencave Politike të Universiteti të Vjenës (2005- 2008). Specializoi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe në

teoritë politike bashkëkohore. Në vitin 2009 u zgjodh mësimdhënës në departamentin e shkencave politike të Fakultetit Filozofik të UP-së. Ishte pjesëmarrës aktiv në simpoziume shkencore dhe programe shkëmbimesh akademike. Ka publikuar një numër të hulumtimeve shkencore, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Është autor i librave “Shtet-ndërtimi nga Kombet e Bashkuara” (Saarbrücken, 2009) dhe i doracakut “Analiza e politikave publike” (2011). (Adem Beha)

BALIU Begzad (1966-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Makresh të Poshtëm, komuna e Gjilanit. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Prishtinë. Ka qenë kryeredaktor i revistës “Shenjzat” (1998-2000) dhe drejtues i shtëpisë botuese me këtë emër, më pas redaktor i kulturës në të përjavshmen “Pasqyra” (Prishtinë). Ka punuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës (1996-2004), ku ka kryer studimet pasuniversitare dhe ka doktoruar në vitin 2003. Nga viti 2004 është ligjërues në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit. Ka qenë kryeredaktor i revistës “Edukologjia” (2008). Nga 2009 është ligjërues i akredituar në studimet e doktoratës në Universitetin e Shkupit dhe ligjërues në Universitetin e Tetovës. Botoi artikuj nga fusha e kulturës, e gjuhësisë, e letërsisë, e folklorit dhe e historisë. Disa nga veprat: “Onomastika e Kosovës” (2008), “Kërkime albanologjike” (2010), “Kujtesa letrare” (2013), “Onomastika dhe dokumenti” (2016) etj. (Agnesa Hasimja)

BALOGH Lajosh (Lajos) (1927-). Aktor. Lindi në Novi-Sad. Në Teatrin Popullor Krahinor u inkuadrua nga viti 1963. Ishte aktor me fizik ekspresiv dhe me diapazon të gjerë vokal. Realizoi një sërë rolesh në shfaqje të shumta, prej të cilave mund të veçohen: “E shoqja e Hasan Agës”, “Kukulla e Kozetës”, “Mbreti nga Betajnova”, “Zgjimi i vampireve” etj. Për rolin e Panteliqit në shfaqjen “Strofulla e ujkut” në vitin 1975 mori çmimin aktori më i mirë në Takimet Teatrorë “Joakim Vujiq” në Uzhiçë të Serbisë. (Fadil Hysaj)

BALOSHEVIQ Stefan (1938-). Mjek, infektolog, profesor universiteti. Lindi në Juzhni Brod, Maqedoni. Mbaroi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit. Pas studimeve u punësua në Spitalin

e Përgjithshëm të Prishtinës, në repartin e sëmundjeve infektive. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u emërua asistent i infektologjisë. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës nga fusha e epidemiologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1975). U zgjodh docent në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, pastaj profesor inordinar dhe ordinar i lëndës së infektologjisë me mësim në gjuhën serbokroate. Ishte prodekan i Fakultetit të Mjekësisë dhe drejtor i Klinikës Infektive në Prishtinë. Në zhvillimet politike të viteve '90 luajti rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave diskriminuese ndaj shqiptarëve. Kur shëndetësia e Kosovës u vendos nën masa të dhunshme, ai mori iniciativën që klinikat e Fakultetit të Mjekësisë të shndërrohen në Qendër Klinike Spitalore, ku u emërua drejtor i përgjithshëm. (Muharrem Bajrami, Shemsedin Dreshaj)

BALSHAJT. Familje bujare arbërore, që u shfaq në histori në shek. XIV, në një qytet të antikitetit të quajtur *Balletium*. Principata e tyre përfshinte pjesën më të madhe të Arbërisë, me qendër në Shkodër. Themeluesi i saj Balsha I (vdiq më 1362) me tre djemtë e tij, Strazimirin (vdiq më 1372), Gjergjin I (vdiq më 1379) dhe Balshën II (vdiq më 1385), që nga viti 1360 u shfaqën si sundimtarë të Gentës (Zetës), Tivarit, Budvës, Shkodrës dhe Drishtit, si bërthamë territoriale e Balshajve gjatë gjithë sundimit të tyre. U fuqizuan pas vdekjes së Stefan Dushanit (1355) dhe sundimit të Uroshit I, kur edhe filloi copëtimi i shtetit të Rashës. Me ndihmën e Raguzës dhe Venedikut, si dhe të sundimtarëve të vegjël të Arbërisë Veriore, fillimisht e zgjeruan territorin e principatës së tyre nga Drishti në Ulqin. Në vitin 1372, Gjergji I i zgjeroi zotërimet e veta në drejtim të Kosovës, duke përfshirë në kufijtë e Principatës së Balshajve edhe një sërë qytetesh si Prizrenin, Pejën, Trepçën etj. Pas vdekjes së Gjergjit I, zotërimet e Balshajve në Kosovë hynë në kuadër të kryezotërinjve shqiptarë në ngritje, të Dukagjinëve e Kastriotëve. Një pjesë që përfshirë brenda zotërimeve të rajonit të Vuk Brankoviqit. Përqafimi i fesë katolike nga pjesëtarët e kësaj dinastie (1369) pat ndikim në zhvillimet e mëvonshme. Pasi zotëronin me Pejën gjatë viteve '70-80 të shek. XIV, së pari kryesuan kuvendet kishtarë në Pejë (1375,

1385) dhe më pastaj ndërmorën hapa për dëbimin e patriarkut të Pejës nga selia. Një përpjekje e këtillë u bë realitet pas vitit 1380, kur kisha rasiene u shpërngul nga Peja në Zhiçë të Rashës, prej nga ishte transferuar këtu në vitin 1253. Në këtë kontekst duhet përmendur edhe famullia romane-katolike e Pejës, e cila përmes dokumenteve zyrtare dëshmohej së paku nga viti 1388.

Principata e Balshajve e arriti kulmin e fuqisë së saj në kohën e sundimit të Balshës II. Balshajt, të cilët në burimet e kohës njiheshin si "sundues të Arbërisë" arritën të sundonin në një territor kompakt shqiptar nga Budva e Tivari, rrethet e Novobërdës deri në Himarë, dhe nga brigjet e Adriatikut e Jonit deri thellë në viset lindore dhe verilindore të Arbërisë. Por Karl Topia me ndihmën e osmanëve e theu ushtrinë e Balshës II në Betejën e Savrës (1385), me çka Principata e Balshajve merr tatëpjetën. Trashëgimtarët e Balshës II, Gjergji II Starazimiri dhe Balsha III nuk arritën t'u bënin ballë armiqve të shumtë, venedikasve, osmanëve, sundimtarëve të Rashës dhe feudalëve të nënshtruar shqiptarë. Pasardhësit e kësaj dinastie mbetën vetëm si zotërues në disa pjesë të bregdetit të Arbërisë dhe bashkëlufetarë të Skënderbeut. (Gazmend Rizaj)

BALLATA Lule (1982-). Flautiste, pikoliste. Lindi në Prishtinë. Mësimet për flaut në Shkollën e Ulët, të Mesme të Muzikës dhe Fakultetin e Arteve i kreu te prof. Venera Mehmetagaj. U magjistrua në Fakultetin e Muzikës në Shkup. Kreu disa masterklasa në Shqipëri, Maqedoni, Slloveni, Itali, Francë, Angli e Austri. Performoi me solistë të njohur në Austri dhe u prezentua në festivalin "Java e Bach-ut 2000"; Muzika kamerale 2006; "Remusica" 2002, 2007; Festivali "DAM" 2007; "Tingujt e flautit" 2002, 2009; "Shopen Piano-Fest" 2011; "Art në tri harqe" Shqipëri - 2001; "Linz Kulturhapstadt Europas" Austri 2009. Ishte pedagoge e flautit në Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë e Pejë. Më 2012 dha mësim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, ndërsa nga 2003 ishte flautiste/pikoliste e Orkestrës Frymore të FSK-së, pastaj pikoliste në Filarmoninë e Kosovës (2006-2013). U shqua me recitalet: "Sonata Night", "Duo Recital" me baritonin E. Oda, shoqëruar nga pianistet L. Pula, E. Ibrahim; soliste në veprën e A. Kocit, shoqëruar nga Filarmonia e Kosovës; koncertet

në “Ditët e Muzikës Kosovare”; bashkësoliste në koncertin solemn për nder të Pavarësisë së Kosovës (Lubjanë, 2008) etj. Jeton dhe vepron në Nju-Jork. (Arnisa Rexhepi)

BALLATA Selim (1945-). Kompozitor, kantautor, mësimdhënës i muzikës. Lindi në Gjakovë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren. Studioi dhe u diplomua në Akademinë e Muzikës në Beograd, drejtimi teorik-pedagogjik. Atje ndoqi dhe Shkollën e Mesme Instrumentale për klarinetë. Më 1968 filloi të kompozojë këngë argëtuese me tematikë rinore, lirike, dashurie. Kompozoi këngën “Duke prituri rrijsha” dhe u paraqit si kantautor në Festivalin e Rinisë në Suboticë. Krijimet tjera: “Lamtumirë vuajtje” (“Akordet e Kosovës”, 1968, çmimi i parë); “Ti më je shumë larg” (“Akordet e Kosovës”, 1969, çmimi i parë); “Ku është dashuria” (“Akordet e Kosovës, 1970, çmimi i dytë); pastaj “Thuaj se më do”, “Buzë Drinit”, “Ata sy s’i harroj” etj. Më 1970 u punësua mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, ndërsa më 1972 në atë të Prishtinës. Për më shumë se 30 vjet ishte mësimdhënës i lëndëve teorike muzikore deri në pension. (Kristina Palokaj-Përkola)

BALLATA Zeqirja (1943-). Kompozitor, muzikolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren (1963), u diplomua në degën e kompozimit të Akademisë së Muzikës në Lubjanë (1967) dhe u laurua me “Çmimin universitar të Preshernit”. Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare tek akademik L. M. Shkerjanc (1969). Ndoqi dhe studimet e rregullta në degën e muzikologjisë në Fakultetin Filozofik (1965-1969). Bëri specializime tremujore në Venecie dhe në Accademia Chigiana në Siena, si dhe në Romë. Më 1971 u zgjodh profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe më pas në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës për lëndët kompozim dhe orkestrim. Në këtë Akademi gjatë periudhës 1975-1981 ishte prodekan dhe dekan. Pas dëbimit me dhunë nga Universiteti (1991) u ftua profesor në Shkollën e Mesme të Muzikës, më pas Konservator, në



ZEQIRJA BALLATA

Maribor të Sllovenisë për lëndët harmoni/kontrapunkt/ forma muzikore, ku zhvilloi aktivitet të ngjeshur muzikor prej pedagogu, kompozitori, pianisti me vepra e koncerte autoriale (Maribor, Lubjanë, Tiranë, Prishtinë, Ulqin, Salzburg). Më 2007 u kthye në Fakultetin e Arteve në Prishtinë dhe ligjëroi lëndët veglat muzikore e aranzhim, përkatësisht kompozim e orkestrim, deri më 2013. Ishte bashkëthemelues i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (1972), i Festivalit “Ditëve të Muzikës Kosovare” (1979), bashkautor i elaboratit për themelimin e degës së muzikës të Fakultetit të Arteve (1974), kryetar i garave federative të nxënësve/studentëve të akademive muzikore (1984). Nga viti 1991 është anëtar korrespondent, më pas anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Mori një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh në Kosovë, në Slloveni, Suedi etj. Opusi i tij kap një numër të madh veprash të gjinive dhe të formave muzikore: 42 vepra korale: 15 këngë solo, 15 vepra pianistike, 31 solistike-instrumentale, 34 kamerale, 9 vokalo-instrumentale, 2 muzikore-skenike. Veprat e tij janë ekzekutuar në koncerte e festivale: në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, Slloveni, Serbi, Itali, Kroaci, Austri, Shqipëri, Gjermani, Bullgari, SHBA dhe janë botuar në Slloveni, Kosovë, Holandë, Shqipëri. Botoi punime muzikologjike dhe mbajti kumtesa në tribuna, simpoziume e tryeza muzikologjike. Botoi librat: “Gjurmëve të muzës” (1978), “Veglat muzikore” (1990), “Edukata muzikore” VIII. Është përfshirë në një sërë botimesh të specializuara nga fusha e muzikës në hapësirat e ish-Jugosllavisë, në Shqipëri dhe më gjerë. (Reze Kryeziu-Breznica)

BALLI KOMBËTAR. Organizatë nacionaliste dhe antikomuniste shqiptare e themeluar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi si nevojë për organizimin e rezistencës kombëtare, që në ditët e para të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Me emrin Organizata e Ballit Kombëtar, program i së cilës në fillim ishin “tetë pikat e nacionalizmit shqiptarë” të Mid’hat Frashërit (1939) dhe më vonë “Dekalogu”, u paraqit në nëntor të vitit 1942. Pikat kryesore të “Dekalogut” ishin Shqipëria etnike, demokratike dhe moderne, liria e fjalës dhe e mendimit, çlirimi i Shqipërisë nga sundimi i huaj dhe respektimi i të gjitha vlerave të kombit. Balli Kombëtar dhe Partia Komuniste e Shqipërisë arritën të

bashkërendonin qëllimet e tyre politike me Marrëveshjen e Mukjes, të nënshkruar më 2 gusht 1943. Por komunistët shqiptarë, nën presionin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, e mohuan dhe e prishën marrëveshjen në shtator të vitit 1943, duke nxitur luftën civile në Shqipëri dhe në mbarë trevat shqiptare. Pas rënies së Italisë fashiste, Balli Kombëtar formoi nën Gjermaninë naziste një qeveri të përkohshme, por pas disa fitoreve fillestare ndaj forcave komuniste, me dobësimin e Gjermanisë, Balli e humbi mbështetjen e gjermanëve dhe, si rrjedhojë, humbi edhe luftën kundër komunistëve. Në Kosovë Balli Kombëtar formoi organizatën e vet në Shkollën Normale-Gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Bërthamën e organizatës e formoi Vasil Andoni në fund të shtatorit 1943, si lëvizje të rezistencës kundër okupatorit. Këtë bërthamë e përbënin: Vasil Andoni, Luan Gashi, Ali Agushi, Xhavit Veseli, Selman Krasniqi dhe Ali Riza Roka. Shkolla Normale “Sami Frashëri”, përmes mësuesve për shkollat shqipe, përhapri rrjetin e komiteteve të Ballit në Kosovë dhe në territoret shqiptare. Komitetet kishin sesionin ushtarak për mobilizimin e ushtrisë vullnetare për mbrojtjen e kufirit të Shqipërisë etnike dhe mbanin lidhje të ngushta ndërmjet veti dhe bashkëpunonin me Muharrem Bajraktarin në zonën kufitare të Shqipërisë. Nga nxënësit e Normales, ndër ithtarët më të njohur të Ballit Kombëtar ishin: Xhahid Gafurri, Ibrahim Spahija, Hasan Gafurri, Hamdi Berisha, Nazif Bogujevci dhe femrat: Igballe Çuni, Sofie Feta, Karolina Ferani, Shukrije Zymi, të cilat më vonë për aktivitetin e tyre do të përjashtohen nga shkolla dhe do të burgosen si nacionaliste. Për shkak të rrjedhës së mëtejshme të ngjarjeve, veçmas në Kosovë, shumica e ithtarëve të Ballit Kombëtar e zhvilluan aktivitetin e tyre si pjesëtarë të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. (Daut Bislimi)

BALLKANI. Ballkani njihet me emrat Gadishulli Ballkanik, Siujdhesa Ballkanike ose Europa Juglindore. Emri vjen nga mali Ballkan, siç e ka quajtur gjeologu Ami Boué (1794-1881), sipas malit Ballkan apo Stara Pllanina, siç e quajnë bullgarët dhe serbët. Fjala Ballkan është me prejardhje turke, që do të thotë mal. Sipas Boué-së, dhe të tjerëve para dhe pas tij, të gjitha vendet në jug të Stara Pllaninës e përbëjnë Ballkanin (Bullgaria, Maqedonia, Shqipëria,

Greqia). Si siujdhesë është e papërcaktuar mirë. Në literaturën profesionale dhe në botime enciklopedike ekzistojnë disa definicione për përkufizimin e kësaj hapësire. Veçanërisht paraqitet i paqartë kufiri verior. Sipas një pikëpamjeje, kufiri natyror në veri shkon përgjatë lumenjve Danub-Sava-Kupa deri te Gjiri i Rijekës, që është konsideruar deri vonë edhe si kufi kulturor dhe politik. Edhe pse nuk bëhet fjalë për siujdhesë të vërtetë, megjithatë, ky emërtim është përdorur për një rajon më të gjerë. Sipas pikëpamjes tjetër, veçanërisht të gjeografëve serbë (Cvijiqi etj.), siujdhesa ka shtrirje më të gjerë dhe shkon përgjatë Danubit, Savës deri te Ljubljansko Barje dhe lumit Idrica në Soçë, duke përfshirë Adriatikon Verior. Shtrihet përgjithësisht ndërmjet detit Adriatik në perëndim dhe Detit të Zi, Marmara dhe Egje në lindje, përgjatë rrjedhjes së poshtme të Danubit dhe luginës së Savës në veri dhe deri te deti Mesdhe në jug. Pikëpamja serbe, përmes këtij versioni, ka pasur për qëllim zgjerimin e aspiratave dhe dominimit të serbizmit në gjithë territorin e sllavëve të jugut. Në këta kufij, sipas vlerësimeve, Ballkani përfshin: Bullgarinë (100%), Maqedoninë (100%), Greqinë (85%, pa ujdhesa), Shqipërinë (100%), Kosovën (100%), Malin e Zi (95 %, pa Bokën), Bosnjën dhe Hercegovinën (100%), pjesë të Kroacisë (47%), një pjesë të madhe të Serbisë (75%, pa Vojvodinën), Rumaninë (9%, Dobruha) dhe pjesën europiane të Turqisë (5%, Rumelia). Politikisht Ballkanit i përkasin Greqia, Bullgaria, Serbia, Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Rumania dhe Turqia. Kufiri fiziko-gjeografik i tij nuk përputhet me kufirin etnografiko-politik. Kroacia dhe kroatët nuk pranojnë ta quajnë veten as Ballkan, as Siujdhesë Ballkanike, e as Ballkan Perëndimor, me arsyetim se emri Ballkan ka domethënie përbuzëse.

Brigjet perëndimore të Gadishullit Ballkanik lagen nga ujërat e detit Adriatik dhe Jon, ndërsa në lindje nga ujërat e detit Egje, Marmara dhe Detit të Zi. Përmes ngushticave të Bosforit dhe Dardaneleve, Ballkanit i mundësohet komunikimi me Gadishullin e Azisë së Vogël. Në anën e kundërt, Kanali i Otrantos, i gjerë 75 km², e ndan Gadishullin Ballkanik nga ai Apenin.

Nga përcaktimi hapësinor varet edhe madhësia e Ballkanit, që sillet midis 475,000 deri 785,000 km². Diku e gjejmë se Gadishulli Ballkanik ka

një shtrirje prej 950 km në drejtimin veri-jug dhe 1,200 km në drejtimin lindje-perëndim. Format dhe strukturat e mëdha gjeologjike të këtij Gadishulli janë krijuar gjatë orogjenezës alpine, derisa pjesa qendrore dhe jugore i takon masivit thrako-maqedonas-dardan. Gjatë etapave gjeotektonike recente dhe të sotme, të cilat veçohen me karakterin e theksuar tipik të formës së blloqeve, ky masiv u copëtua në një sërë blloqesh, të ndara nga shkëputje normale, duke u shprehur mjaft qartë në format e sotme të relievit (struktura e formës së shahut). Krahas vargjeve malore e kodrinore, në relievin e Gadishullit Ballkanik përfshihen edhe ultësirat, fushëgropat ndërkalore ose në periferi. Të tilla janë: ultësira e Vllahisë (Danubi i poshtëm), ultësira perëndimore e Shqipërisë, ajo e Thesalisë, e Maricës, Rrafshi i Dukagjinit, Rrafshi i Kosovës, fushëgropa e Shkupit, e Pollogut, e Pellagonisë etj. Gadishulli Ballkanik i takon zonës së klimës së mesme kontinentale, subtropikale mesdhetare dhe transitore. Hapja e Gadishullit në drejtim verior dhe verilindor mundëson depërtimin e masave të ftohta ajrore nga ultësirat e Europës Lindore. Këto masa, duke u lëshuar në drejtim të jugut, modifikohen dhe në brendësinë e Gadishullit Ballkanik kushtëzojnë klimën e mesme kontinentale. Në pjesën jugore dhe perëndimore të gadishullit, për shkak të ndikimit të shprehur maritim mesdhetar, klima ka të gjitha veçoritë mesdhetare e subtropikale. Në brendësi të rajonit, klima merr tipare transitore, sepse shfaqen disa karakteristika të klimës kontinentale, duke pësuar ndryshime të theksuara të treguesve të temperaturës e të reshjeve. Në zonën e klimës mesdhetare dimri është relativisht i ngrohtë dhe i lagësht, ku temperatura mesatare vjetore e muajit janar lëviz nga 11°C në brigjet jugore, deri në 4°C në brigjet veriperëndimore. Sasia më e madhe e reshjeve bie në brigjet e Adriatikut me mbi 2,000 mm reshje në vit. Në lokalitetin Cërkvice të Bokës së Kotorrit (Mali i Zi) është regjistruar maksimumi absolut i reshjeve për tërë kontinentin e Europës, me 5,317 mm reshje. Reshje të shumta, mbi 3,000 mm, bien edhe në Alpet Shqiptare, Karpatet Lindore etj. Në veri të maleve të Ballkanit klima merr karakter të theksuar kontinental. Klimë e tillë dominon në ultësirën bullgare, të Vllahisë, pllajën e Moldavisë, Transilvanisë, fushën e Danubit. Në këto territore temperaturat gjatë

dimrit mund të zbrasin edhe deri në -15°C. Territori i Gadishullit Ballkanik u takon pellgjeve ujëmbledhëse të Detit të Zi dhe atij Mesdhe. Lumi më i madh i Ballkanit dhe i dyti në Europë, pas Vollgës, është Danubi, i cili derdhet në Detin e Zi. Lumenjtë e tjerë janë: Tisa, Mureshi, Sava, Drina, Bosnja, Morava, Drini, Vardari etj. Lumenjtë e pellgut mesdhetar kanë prurje maksimale gjatë dimrit dhe minimale gjatë verës, por disa prej tyre, si Neretva, Buna, Mati, Shkumbini e Vjosa ushqehen me ujë edhe nga shkrirja e borës, andaj kanë regjim të përzier.

Gadishulli Ballkanik gjatë gjithë historisë ishte skenë e lëvizjeve, kontakteve dhe konflikteve të popujve dhe kryqëzimit e shtresëzimit të kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Përveç konflikteve të brendshme të pandërprera, veçanërisht këta dy shekujt e fundit, hapësirat ballkanike u bënë joshëse edhe për okupimet dhe dominimet e huaja. Gadishulli ishte dhe mbeti një neuralgjike historiko-politike, gjeopolitike dhe etnodemografike. Disa vende ballkanike, në radhë të parë Serbia, të përkrahur nga Fuqitë e Mëdha, në këto konstelacione gjeopolitike filluan t'i jetësojnë synimet e tyre hegjemoniste për zgjerim territorial, duke pushtuar popujt dhe territore fqinje, veçanërisht shqiptarët. Deri në fund të shekullit XX, Ballkani mbeti politikisht i pastabilizuar dhe i përshkuar nga tensione dhe konflikte ndër-etnike. Me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe, në vitet '90 të shekullit të kaluar, Serbia i nxiti tri luftëra: në Kroaci, në B e H dhe në Kosovë, duke lënë pas trashëdi të shumta njerëzore dhe dëme të mëdha materiale.

Në Ballkan, në kufijtë e gjerë, jetojnë shumë popuj: grekët (10,8 milionë), turqit (9,2 milionë në pjesën europiane), serbët (6,2 milionë), bullgarët (7 milionë), malazezët (0,4 milionë), shqiptarët (7 milionë), boshnjakët (4,4 milionë), maqedonasit (1,4 milion), rumunët (22 milionë), kroatët (4,5 milionë), me kultura, gjuhë, besime, zakone të ndryshme. Religjionet kryesore janë ortodokse, katolike dhe islame. Shumica e shteteve të të ashtuquajturit Ballkani Perëndimor ende nuk janë përfshirë në Bashkimin Europian. (Hivzi Islami, Arsim Ejupi)

BALLKANISTIKA. Disiplinë e gjuhësisë që merret me studimin e tipareve të përbashkëta gjuhësore (por jo të trashëgimisë së përbashkët indoeuropiane) të arealit gjuhësor të

Ballkanit, që përfshin shqipen, rumanishten, greqishten, bullgarishten, maqedonishten dhe dialektin torllak të serbishtes. I pari që vuri re disa dukuri të përbashkëta gjuhësore ballkanike ka qenë gjuhëtari sloven B. J. Kopitar (1829). Pas Kopitarit, me zhvillimin e hovshëm të gjuhësisë krahasuese, dukuritë e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit tërhiqnin gjithnjë e më shumë vëmendjen e gjuhëtarëve të ndryshëm. Por, vetëm pas botimit të monografisë së F. Mikloshiçit (1861) këto dukuri filluan të bëheshin objekt i studimit sistematik. Mikloshiçi ka vënë në dukje një numër dukurish të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit dhe burimin e tyre e kërkonte tek “elementi i lashtë autokton”, i cili, sipas tij, mendohet të ketë qenë i afërt me shqipen, e cila konsiderohet vazhduese e ilirishtes. Ndihejta të rëndësishme për studimin e krahasuar të gjuhëve ballkanike të veçanta e, si rrjedhim, edhe për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve të krahasuara ballkanologjike në përgjithësi kanë dhënë edhe një varg gjuhëtarësh të tjerë, si: K. Sandfeld, H. Pedersen, N. Jokl, P. Skok, M. Budimir, D. Deçev, I. Duridarov, R. Katiç, G. Papahaxhiu, A. Rosetti, V. Georgiev, A. Selishçev, E. Çabej, I. Ajeti, M. Domi, B. Bokshi, B. Beci, R. Ismajli etj. Studimi i krahasuar i gjuhëve ballkanike mori formën dhe përmasat e një disipline të veçantë me botimin e veprës “Gjuhësia ballkanike - probleme dhe rezultate” (Linguistique balkanique - problèmes et résultats) (1930) të gjuhëtarit danez Kristian Sandfeld. Ndër ballkanizmat kryesorë përmenden: zhdukja ose shmangia e paskajorjes, prapavendosja e njëjës shquese, format e futurit me *dua*, sinkretizmi i gjinore me dhanoren, format analitike të kohëve perfektive dhe një leksik i përbashkët. Teoria më e pranuar e krijimit të ballkanizmeve është ajo që thotë se risitë gjuhësore janë krijuar në gjuhë të ndryshme dhe pastaj gjuhët e kanë ndikuar njëra-tjetrën: disa gjurmë mund të ndiqen te latinishtja, disa te sllavishtja a greqishtja e disa te substrati. (Drita Tërshani)

BALLKANOLOGJIA. Kompleks disiplinash shkencore që studion Ballkanin si një unitet historik, kulturor dhe gjuhësor në diversitet. Përmes metodës krahasuese i identifikon dhe i shpjegon zhvillimet paralele ballkanike. Ballkanologjia është një fushë studimi ndërdisiplinore. Merret me tiparet e përbashkëta ballkanike në gjuhë, letërsi, art dhe në tradita

e zakone. Merret edhe me kontaktet ndërmjet popujve të Ballkanit dhe me ndikimet e tyre të ndërsjella, por dhe me ndikimin e dukurive të caktuara ballkanike te popujt dhe kulturat joballkanike dhe anasjelltas. Çështje të tjera me rëndësi për këtë disiplinë janë edhe lëvizja e popullsisë dhe shtresëzimi i saj. Për afrimin popujve të Gadishullit Ballkanik kanë kontribuar rrethanat gjeografike, historike e sociale. Bashkëjetesa e disa popujve në një hapësirë relativisht të ngushtë i ka bërë më intensive shkëmbimet e caktuara ndërmjet këtyre popujve. Ndikimi kulturor i Greqisë, pushteti politik e kulturor i Perandorisë Romake dhe më vonë i Perandorisë Bizantine, ardhja dhe sundimi i sllavëve dhe më vonë i osmanëve, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në një drejtim konvergjent dhe kanë çuar në një farë nivelimi të ndryshimeve etnike e gjuhësore. Afria që ekziston midis gjuhëve ballkanike, e cila mund të quhet një njësi përbrenda ndryshimeve, ka bazat e saj etnografike. Edhe më parë është vënë re se popujt e këtij gadishulli paraqesin elemente të përbashkëta në kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore. Disa çështje të ballkanologjisë janë studiuar dhe paraqitur në kontekstin e historisë, të arkeologjisë, të etnologjisë, të filologjisë klasike, të bizantologjisë, të sllavistikës, të albanologjisë e të orientalistikës. Historiografinë e Ballkanit e kanë themeluar K. Jireček, N. Jorga dhe M. Shuffaj, ndërsa i pari që ka vënë në dukje disa dukuri të përbashkëta gjuhësore ballkanike ka qenë gjuhëtari sloven B. J. Kopitar (1829). (Kadire Binaj)

BANDZIAKA Joana (1963-). Balerinë nga Polonia. Si anëtare-mysafire e trupës së baletit në kuadër të Teatrit Popullor të Kosovës (TPK) në vitet '80 interpretoi disa role të rëndësishme me këtë ansambël. Ndër rolet e saj veçohen: Doruntina në “Besa” të kompozitorit Bashkim Shehu (1985), Karmen në “Karmen” të kompozitorit Zhorzh Bize (1985), Nëna në baletin “Zef Lush Marku” të kompozitorit Akil Koci (1986) etj. Puna e saj ishte e rëndësishme në konsolidimin e trupës së baletit dhe realizimin e shfaqjeve të suksesshme. (Arian Krasniqi)

BANFI Emmanuele (1946-). Gjuhëtar italian, indoeuropianist, ballkanolog. Studioi greqishten moderne, por edhe gjuhësinë ruse, arabe e kineze. Profesor në universitetet e Milanos dhe

të Trentes dhe kryetar i Shoqatës së Gjuhësisë Italiane. Përveç me gjuhësi të përgjithshme dhe indoeuropianistikë, me referencë greqishten dhe gjuhët e Ballkanit, merret dhe me sociolinguistikë, gjuhësi të zbatuar e etnolinguistikë. Probleme të shqipes në kuadër të ballkanistikës ka vështruar në studimet “Zona të latinizuara në Ballkan dhe një zonë e tretë latino-ballkanike (Zona e via Egnatia)” (1985), “Krishterimi në Ballkan dhe formimi i lidhjes gjuhësore ballkanike” (1987), “Histori gjuhësore e Europës Juglindore” (1991), “Gjuhët e Europës” (Lingue d’Europa) (2003), sidomos në veprën sintetizuese “Gjuhësia ballkanike” (Linguistica balcanica, 1985) etj. Është marrë me prapavendosjen e nyjës, me disa bashkëpërkime në fushën e fjalorit, me turqizmat e frazeologjitë e përbashkëta, me mënjanimin e paskajores, për të cilën mbron tezën e ndikimit grek etj., por edhe me problemet historike e sociolinguistike të minoritetit gjuhësor shqiptar në Greqi. (Shpëtim Elezi)

BANKA BOTËRORE. Institucion financiar ndërkombëtar që ofron kredi dhe asistencë zhvillimore për vendet në zhvillim. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim



SELIA E BANKËS BOTËRORE

(BNRZH) apo siç quhet ndryshe Banka Botërore, u themelua në vitin 1944. Për dallim nga bankat komerciale, operimet e BNRZH-së nxiten nga motivi zhvillimor dhe jo nga maksimizimi i profitit. BNRZH-ja ofron kredi

për vendet në zhvillim, të cilat i përkasin grupit të vendeve me të hyra mesatare apo vendeve të varfra, në rastet kur vlerësohet se i kanë plotësuar kushtet për të marrë kredi nga kjo bankë. Për të ndihmuar vendet më të varfra, shtetet aksionare të Bankës Botërore kanë themeluar edhe Agjencinë e Zhvillimit Ndërkombëtar, përmes së cilës synohet rritja ekonomike e vendeve në zhvillim, duke u përqendruar në zvogëlimin e varfërisë dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Klientët e Bankës marrin kredi me kushte më të volitshme sesa nga bankat komerciale, kreditë ofrohen në vëllim më të lartë dhe me periudhë më të gjatë të kthimit. Kreditë lejohen edhe për financimin e infrastrukturës, shëndetësisë, arsimit, energjisë së pastër dhe ruajtjen e mjedisit.

Kosova u pranua në grupin e Bankës Botërore në qershor të vitit 2009. Që nga viti 1999 kjo bankë ka ofruar dhe ka menaxhuar në Kosovë rreth 400 milionë dollarë. Përmes kësaj banke janë mbështetur sektorë të ndryshëm, si: arsimit, energjia, bujqësia, reforma e sektorit publik dhe të sektorit financiar. Të gjitha projektet e mbështetura nga Banka Botërore janë financuar nga grantet e ndryshme, kryesisht përmes të hyrave neto të Bankës, të Fondit të Mirëbesimit për Kosovën, të Fondit të Vendeve të Pasluftës, si dhe përmes Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim. Programi i Bankës Botërore në Kosovë po zbatohet përmes të ashtuquajturës Strategjia e Partneritetit të Vendit FY12-15, e cila synon mbështetjen e Kosovës në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Europian, duke nxitur rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ndihma kryesore e Bankës Botërore në Kosovë është fokusuar në sektorin e energjisë. Përveç kësaj, së bashku me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (International Financial Corporation), Banka Botërore në Kosovë ka mbështetur edhe zhvillimin e një sërë projektsh infrastrukturorë. Mbështetja e këtyre projekteve bëhet në mënyrë të përzgjedhur, duke identifikuar firmat private, të cilat janë të angazhuara kryesisht në fushën e transportit, të ujësjellësit, të mbledhjes së mbeturinave dhe të energjisë. Mbështetja ofrohet edhe në sektorët e prodhimit dhe të financimit dhe, përveç ndihmës financiare, ofrohen edhe shërbime këshilluese me qëllim të përmirësimit të klimës së biznesit në Kosovë. (Venera Demukaj)

BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE. Është bankë e Bashkimit Europian (BE), me seli në Luksemburg, me një rrjet të zyrave lokale dhe rajonale në Europë dhe më gjerë.



SELIA E BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE

Përfaqëson interesat e shteteve anëtare të këtij unioni. Kjo bankë bashkëpunon me institucionet e tjera të BE-së, për të zbatuar politikat e kësaj bashkësie shtetesh. Anëtarët e BE-së janë huamarrësit dhe huadhënësit më të mëdhenj shumëpalësh në këtë bankë. Banka ofron financim dhe ekspertizë për projekte të shëndosha dhe të qëndrueshme të investimeve, të cilat kontribuojnë për të avancuar objektivat e politikave të BE-së, siç është rritja ekonomike dhe punësimi në Europë. Aktivitetet e këtij institucioni mbështeten në katër fusha me prioritet: inovacion dhe shkathhtësi, qasje në financa për bizneset më të vogla, ndikimet klimatike dhe infrastruktura strategjike. Kjo bankë ende nuk ka ndonjë aktivitet domethënës në Kosovë. Situata pritet të ndryshojë me progresin në procesin e integritimeve europiane. (Valentin Toçi)

BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH). Bankë e themeluar në vitin 1991, me qëllim të mbështetjes së transicionit të ekonomive të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore. Fokusi primar i BERZH-it është zhvillimi i sektorit privat. Banka është në pronësi të vendeve të Bashkimit Europian dhe të Bankës Europiane për Investim. Kosova iu bashkua BERZH-it më 17 dhjetor 2012, por edhe para kësaj date, që nga viti 1999, përmes fondeve rajonale kjo bankë ka mbështetur projektet për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Deri në fund të vitit 2014, BERZH-i ka mbështetur 39 projekte

dhe ka distribuuar 75 milionë euro në Kosovë. Mbështetja e BERZH-it është e fokusuar në tri fusha. Fusha e parë ka të bëjë me mbështetjen e procesit të privatizimit si dhe zhvillimin e sektorit privat. Asistenca e ofruar në këtë fushë është e natyrës financiare dhe teknike, ku rëndësi të veçantë kanë përmirësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe tërheqja e investimeve të jashtme. Fusha e dytë mbulon projektet që nxitin konkurrencën dhe angazhimin e sektorit privat në zhvillimin e infrastrukturës, me theks të veçantë në sektorin e ujërave, pastrimit dhe transportit. Fusha e tretë ka të bëjë me sektorin e energjisë. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë përfshin mbështetjen e investimeve për sigurimin e energjisë elektrike, zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë (Venera Demukaj).

BANKA QENDRORE E KOSOVËS (BQK). Autoritet i licencimit dhe i mbikëqyrjes së bankave dhe të institucioneve të tjera financiare në Kosovë. Pikënisje për formimin e këtij



GODINA E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

institucioni dhe të sistemit bankar në Kosovë në kushtet e reja ishte nëntori i vitit 1999, kur u themelua Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, me ç'rast u vunë themelet e një sistemi financiar modern. Më 15 qershor të vitit 2008, me aprovimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me hyrjen në fuqi të ligjeve përkatëse u bë transformimi i këtij institucioni në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Objektivat kryesore të BQK-së janë: të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave; të

kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; të mbështesë politikën e përgjithshme ekonomike të qeverisë dhe, në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur dhe të konkurrencës së lirë, të stimulojë shpërndarjen efikase të burimeve financiare. Për shkak të shfrytëzimit të euros si valutë zyrtare në Kosovë, BQK-ja është e limituar në ushtrimin e politikës monetare. Sidoqoftë, për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit financiar, roli i saj është shumë i rëndësishëm në rregullim, mbikëqyrje dhe licencim, përfshirë bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet e pensione, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë. Banka Qendrore vazhdimisht azhurnon rregullat financiare, të cilat janë në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Nga këndvështrimi i rregullave, sektori bankar në Kosovë mund të konsiderohet liberal, pasi nuk ka kontroll të normave të interesit, programe të orientimit të kreditimit etj. Barrierat e hyrjes në treg dhe limitimet në zgjerimin e rrjetit bankar bazohen vetëm në analiza të arsyeshmërisë, që aplikohen nga ana e Bankës Qendrore. Funkcion tjetër me rëndësi i BKQ-së është edhe krijimi i infrastrukturës për zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të pagesave, përmes avancimit të sistemit ndërbankar të tyre. Si funksion tjetër me rëndësi mund të konsiderohen analizat mbi stabilitetin financiar dhe ecuritë ekonomike, të cilat ndihmojnë ndërmarrjen e masave të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Po ashtu, Banka Qendrore kryen një varg funksionesh të tjera, siç është ai i bankierit për agjencitë qeveritare, i përpiluesit të statistikave financiare dhe të bilancit të pagesave, i administruesit të regjistrimit të kredive të Kosovës, i furnizuesit të ekonomisë me para të gatshme dhe i këshillëdhënësit për politika ekonomike etj. (Arben Mustafa)

BANJA “NËNA NAILE”, KLLOKOT. Është afër qendrës terapeutike rehabilituese të Banjës së Kllokotit. Efektet shëruese të banjës së re në Kllokot “Nëna Naile” u referohen burimeve natyrore ujore të Banjës së Kllokotit, përkatësisht ujërave termominerale, temperatura natyrore e të cilave sillet prej 22°C-36°C dhe pelloidës (përzjerja e ujit mineral me materie joorganike kimike). Veprimet mjekuese janë po ato që i referohen Banjës së Kllokotit: sëmundjet reumatizmale, kardiovaskulare, pastraumatike,

neurologjike, të traktit gastrointestinal/hepatobiliar, të veshkave dhe të rrugëve urinare, gjinekologjike si dhe të lëkurës. Qendra “Nëna Naile” ka tri pishina të brendshme dhe 40 vaska mjekuese me ujë termal si dhe 4 salla me pajisje moderne për ushtrimin e terapive fizikale. Kompleksi ka 600 shtretër, ndërsa përkujdesjen e ushtrojnë disa specialistë fiziatër, mjekë familjarë vendorë dhe disa kinezë që merren me masazh dhe akupunkturë, pastaj disa teknikë dhe laborantë mjekësorë. (Isme Humolli)

BANJA E BANJSKËS. Burim termomineral, që gjendet në rrëzën juglindore të malit Rogozna, në lartësi mbidetare 533 m, rreth 12 km në veri të Mitrovicës. Bëhet fjalë për katër burime, tre prej të cilëve janë më kryesorët dhe janë kaptuar me punime ujëmarrëse, me prurje të ujit rreth 8 l/sek. Temperatura e ujit, varësisht prej burimit, lëkundet nga 28.3°C-58.1°C. Për nga vetitë fiziko-kimike të ujit, burimet termale të Banjskës bëjnë pjesë në grupin e ujërave alkaline, me një përqindje të sulfatëve, pH prej 7.1-7.4. Me qëllim shërues, ujërat e Banjskës janë përdorur që nga koha antike, gjatë mesjetës, si dhe në ditët e sotme. Shfrytëzimi i organizuar i ujërave për qëllime mjekuese ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore (1949-1956), me kaptimin e tri burimeve, me ç’rast prurjet e ujit janë shtuar nga 1,75 l/sek në 4,9 l/sek. Deri para 10 vjetësh në këtë banjë qëndronin deri 5,000 klientë brenda vitit. Aktualisht kapacitetet e banjës kanë dalë jashtë përdorimit. Ujërat termale të Banjskës janë shëruese për shumë sëmundje, në veçanti për sëmundje të eshtrave dhe të lëkurës. (Bektesh Vidishiqi)

BANJA E BUJANOCIT. Banjë termale në Luginën e Preshevës. Ndodhet në fshatin Rakoc, afër Bujanocit. Temperatura mesatare e ujit sillet prej 24.5 deri 43.0°C, vlera e pH-së është 6.8 dhe përmban CO₂. Ujërat i takojnë klasës të hidrokarbonatëve dhe nënklasës së natriumit. Për shkak të karakteristikave të volitshme fiziko-kimike, si temperatura, përbërja mineralogjike, përmbajtja e gazeve të ndryshme, ujërat e kësaj banje shfrytëzohen në balneologji për trajtimin dhe shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Për shërimin e sëmundjeve reumatike shfrytëzohet balta, e cila quhet peloid. Balta peloidet e Banjës së Bujanocit përbëhet prej mineraleve të feldspatit, kuarcit, kalcitit dhe mineraleve të argjilës. Përmes përzjerjes së



BANJA E BUJANOCIT

peloidit me parafinë prodhohet parafangoja, e cila përdoret si mjet ndihmës për shërim shtëpiak. Ujërat termominerale të Banjës së Bujanocit, me vetitë e tyre shëruese si dhe me pozitën e volitshme gjeografike (ndodhet vetëm 2.5 km larg magjistrales automobilistike dhe hekurudhore ndërkombëtare) paraqesin një mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit shëndetësor dhe balnear në këtë rajon. Për këtë qëllim janë ndërtuar kapacitetet receptive për turistët. Në vitin 1991 filloi ndërtimi i një kompleksi turistik dhe rekreativ me një sipërfaqe prej 14,000 m² me 300 shtretër. Punët në ndërtimin e këtij kompleksi ende nuk kanë përfunduar. Ujërat termominerale kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve industriale për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit të pijshëm. (Arsim Ejupi)

BANJA E KLLOKOTIT. Burim i ujërave termominerale, vendmjekim i njohur që nga kohërat e vjetra, ndodhet në vendbanimin e Kllokotit, ndërmjet Ferizajt dhe Gjilanit. Ujërat termale në Banjën e Kllokotit dikur shfaqeshin në formë burimesh në lartësi mbidetare 483 m, me lirim të konsiderueshëm të dioksidit të karbonit, në sedimentet aluviale të anës së djathtë të lumit Morava e Binçës, në kryqëzimin e dy thyerjeve tektonike të thella, ndërsa sot ujërat nxirren përmes puseve, shpimeve të thella (166 dhe 178 m, me vetëderdhje - gejzer 18 l/sek, përkatësisht me ujdëhënie 78 l/sek) të thellura në ambientet gjeologjike të përbëra nga shkëmbinj të dhe brekçiet e leucito-trahiteve dhe shkëmbinj të karbonatikë (mermerët). Ujërat termominerale të Banjës së Kllokotit kanë temperaturë prej 18°C deri 40°C dhe u takojnë ujërave të tipit klorur hidrokarbonat i natriumit, me elemente specifike të acidit silicik dhe borik, litiumit, fluorit, hekurit, ra-



BANJA E KLLOKOTIT

donit dhe stronciumit, mesatarisht të mineralizuara (1,470-4,400 mg/l), me përbërje të lartë të dioksidit të karbonit (274-1780 mg/l). Ujërat e ftohta minerale (16-18°C) shfrytëzohen për shërim me pirje, për prodhimin e ujërave të mbushur në shishe ("Ujë Kllokoti") dhe për prodhimin e gazit të dioksid karbonit për industri. Ujërat minerale hipotermale (26-37°C) shfrytëzohen për qëllime balneologjike: rekreacion, shërim dhe rehabilitim në kuadër të Banjës së Kllokotit, e cila disponon qendrën mjekësore rehabilituese, kapacitetet hoteliere moderne dhe me infrastrukturën përkatëse. Ujërat shëruese të Banjës së Kllokotit, të përdorur si ujë për pije, inhalim, hidroterapi etj., shërbejnë për mjekimin e shumë indikacioneve të sëmundjeve kardiovaskulare, të lukthit, të veshkave, të mëlçisë, të sëmundjeve reumatike, të sistemit nervor, të lëkurës, të gjendjeve postraumatike etj. Për shërim të sëmundjeve të lëkurës përdoret edhe peloidi (lym shërues). Për ujin shërues, ambientin e ruajtur natyror, klimën e këndshme e të shëndoshë, si dhe me objektet bashkëkohore mjekësore-hoteliere, Banja e Kllokotit paraqet një qendër të përshatshme shëndetësore-rekreative në Republikën e Kosovës. (Vahdet Pruthi)

BANJA EMALISHEVËS. Burim termomineral i ujërave nëntokësore, i tipit karstik-çarshmëri, në anën e majtë të lumit Mirusha, në fshatin Banjë, afër 4 km në juglindje të Malishevës. Buron në kontakt të gëlqerorëve të kretakut



BANJA E MALISHEVËS

me sedimentet e pliocenit, në lartësi mbidetare 570 m. Prurja e ujit është 40 l/sek, ndërsa temperatura 26.0°C. Për nga përbërja kimike, uji i takon tipit hidrokarbonat të Ca-Mg, me mineralizim 0.64 g/lit, me prani të dioksidit të karbonit, të azotit dhe me përbërje të rritur të radiumit. Uji i Banjës së Malishevës është shërues për sëmundjet e lëkurës. Për nevoja balneologjike, rekreative e sportive, afër burimit është ndërtuar një basen i tipit olimpiq, me dimensione të përafërta 25x50 m, i cili frekuentohet nga shumë vizitorë, kryesisht të vendbanimeve përreth. (Vahdet Pruthi)

BANJA E PEJËS. Burim karstik me vetëderdhje (artezian) i ujit termomineral, banjë e njohur qysh nga periudha romake, gjendet në Rrafshin e Dukagjinit, në verilindje të Pejës, në largësi



KOMPLEKSI HOTELIER I BANJËS SË PEJËS

rreth 12 km, me lartësi mbidetare 550 m. Ujërat termominerale burojnë përgjatë çarjeve tektonike, të lidhura në thellësi me shkëmbinj karbonatikë të mesozoikut, nga të cilat në sipërfaqe janë depozituar masa të mëdha të travertinës-oniksit, ndërsa në burimin kryesor të ujit masa të bigrit. Prurja ujore e burimeve është 17.5 lit/sek, ndërsa temperatura 46-48°C. Për nga përbërja kimike, uji i përket tipit hidrokarbonat të Na-Ca-Mg, me prani të dioksidit të karbonit dhe komponenteve specifike të Ra, Sr, Ba, Li, SiO₂ dhe mineralizim 2,040 g/l. Burimi i ujit termomineral është i kaptuar me punime ujëmarrëse dhe shërben për nevojat e banjës, e cila ka qendrën mjekësore stacionare për mjekësi fizikale dhe për rehabilitim me tri hotele të tjera. Uji termomineral i banjës shfrytëzohet për shërimin e sëmundjeve neurologjike, traumatologjike, kardiovaskulare, dermatologjike dhe gjinekologjike. Banja e Pejës disponon edhe hapësira të gjelbëruara dhe parkun, që shfrytëzohen për pushim dhe rekreacion. Kompleksi i Banjës së Pejës (qendra mjekësore, kapacitetet hoteliere dhe hapësirat e gjelbëruara), pronë e dikurshme shoqërore, është privatizuar dhe vazhdon me ofrimin e shërbimeve balneologjike si kompani private. (Vahdet Pruthi)

BANJA E SIJARINËS. Vendbanim në komunën e Medvegjës, 10 kilometra në juglindje të qendrës. Shtrihet në luginën e lumit Banjska, degë e djathtë e lumit Jabllanica. Në vitin 1961 kishte 255 banorë, ndërsa në vitin 2002 ka 632 banorë. Popullsia shqiptare në strukturën etnike të vendbanimit merr pjesë me 48.1% (2002) të banorëve. Në këtë vendbanim ndodhet kompleksi rekreativo-turistik "Banja e Sijarinës". Pjesa dërrmuese e popullsisë është e angazhuar në veprimtaritë shërbyese. Kjo i jep Banjës së Sijarinës karakterin e vendbanimit urban. Prej objekteve të standardit shoqëror, fshati ka shkollën tetëvjeçare, qendrën rehabilituese-shëndetësore, shtëpinë e shëndetit, kinemanë, hotelin etj. Është qendër e bashkësisë lokale për nëntë vendbanime përreth. (Arsim Ejupi)

BANJA. Fshat i tipit të dendur, 15 km në jugperëndim të Istogut. Shtrihet përgjatë rrugës Pejë-Mitrovicë, në lartësi mbidetare 520 m. Popullsia merret kryesisht me bujqësi ekstensive. Në qendër të Banjës, pranë hotelit

të ri, u zbulua një lokalitet i vjetër i quajtur "Tumat në Ilixhë", që dëshmon për lashtësinë e këtij vendbanimi. Përmendet në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 me emrin Bano. Në këtë defter ishin të regjistruara 12 shtëpi. Shfrytëzimi i ujërave termominerale për qëllime shëruese është bërë shumë herët. Me këtë dukuri shpjegohet etimologjia e emrit të këtij vendbanimi. Rrethina e vendbanimit është e pasur edhe me shkëmbinj të mermerëve të tipit onix, të cilët janë përdorur në kohët e lashta, por shfrytëzohen edhe sot për ndërtimin e shtëpive. Në vitin 2011 Banja kishte 1,360 banorë, ndaj 158 banorëve në vitin 1948. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Bajica, Corolluka, Dubova e Vogël, Kashica, Lubova, Orroberda dhe Baja. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9- vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

BANJSKA Gani (1936-2005). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Vushtrri, shkollimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Mitrovicë, Fakultetin e Bujqësisë në Beograd (1962). Një vit punoi mësimdhënës në gjimnazin e Mitrovicës. Më pas zgjidhet asistent në Shkollën e Lartë Bujqësore në Prishtinë (1964) dhe ligjërues për lëndën prodhimtaria e bimëve foragjere në livadhe dhe kullosa. Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1976). Kreu specializimin në Shkollën e Lartë Shtetërore të Bujqësisë e Veterinës në Kopenhagë (1982). Më 1976 zgjidhet docent në Fakultetin e Bujqësisë dhe më pas merr edhe titujt e tjerë universitarë. Botoi një dispensë për lavërtarinë dhe prodhimtarinë e bimëve foragjere dhe disa tekste për shkollat mesme bujqësore. Publikoi një numër punimesh shkencore e profesionale dhe mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore. Gjatë viteve '90 emigroi në Norvegji. Pas luftës, me projekte të ndryshme vendosi marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Os-it dhe Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë dhe ndihmoi ngritjen profesionale e shkencore të stafit mësimor të këtij fakulteti. (Shukri Fetahu)

BAPTISTERI I ULPIANËS. Pagëzimore e krishterimit të hershëm e Ulpianës antike. Është pjesë përbërëse e kompleksit të madh



BAPISTERI I ULPIANËS

kishtar të krishterimit të hershëm, rreth 7.5 m në jug të bazilikës B të Ulpianës. U përdor për pagëzimin e besimtarëve që konvertoheshin nga besimi pagan në të krishterë. Përfshin sipërfaqe prej 120 m², me plan qendror tetëkëndësh (diametri 13 m), me tetë absida të vogla. Në qendër gjendet vaska e pagëzimit për zhytjen pagëzuese. Struktura origjinale është ruajtur vetëm në pjesën e poshtme. Plani tetëkëndësh si metaforë vizuale e numrit 8 simbolizon ditën e ringjalljes së Krishtit, rrjedhimisht fillimin e ri, rilindjen dhe përjetësinë, ndërsa vetë pagëzimi simbolizon ringjalljen nga një jetë mëkatore në atë shpirtërore. Gërmimet arkeologjike u zhvilluan në vitet 2012-2013. (Milot Berisha)

BARAKU Enver (1935-) Mjek, specialist i mjekësisë sociale, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Pejë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1966). Pas diplomimit u punësua si mjek i praktikës së përgjithshme në Gjakovë, e më pas në Entin për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës në Prishtinë, ku u emërua kryeshef i mjekësisë sociale. Specializoi në lëmin e mjekësisë sociale dhe një kohë qëndroi në Paris dhe Gjenevë për perfeksionim nga kjo fushë. Mbrojt tezën e doktoratës më 1980 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Konsiderohet si meritore për hapjen e specializimeve nga degët e mjekësisë preventive. Ka arritur gradën e profesorit ordinar në Fakultetin e Mjekësisë. Ishte mentor i dhjetëra punimeve specialistike, magjistraturave dhe doktoratës nga lëmi i mjekësisë preventive. Është autor i shumë punimeve profesionale të botuara brenda dhe jashtë vendit. Ka udhëhequr në dy mandate studimet për mjekësi publike me epidemiologji. Punoi në Entin për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës

në Prishtinë, sot Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, derisa u pensionua në vitin 2000. (Ilir Begolli)

BARANI Halit (1951-). Veprimtar, aktivist i të drejtave të njeriut. Lindi në Klinë të Epërme të Skënderajt. Më 1973 u angazhua në Teatrin e Qytetit të Mitrovicës dhe nga viti 1978 udhëhoqi këtë teatër. Që nga viti 1989 u angazhua në evidentimin e shkëljes së të drejtave të njeriut në Mitrovicë. Në janar të vitit 1990 u angazhua në degën e Mitrovicës të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Në maj të vitit 1990 mori pjesë në organizimin e zgjedhjeve të mbajtura nga LDK-ja. Në vitin 1991 u emërua kryetar i qendrës rajonale të Mitrovicës të Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Në vitin 1997 u largua nga LDK-ja dhe u angazhua në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fshatin Llaushë. Në mars të vitit 1998 formoi njësitin “Ylli ‘98” prej 28 ushtarëve në Kodër të Baranëve. Gjatë viteve të luftës 1998/99 ishte reporter për radiot “Dojçe Vele”, “Zëri i Amerikës”, “Europa e lirë” dhe për Radiotelevizionin Shqiptar. Në vitin 1999 i dorëzoi gjykatës së UNMIK-ut në Mitrovicë 12 kallëzime penale për krimet e ushtarëve, policëve dhe të civilëve serbë, për gjenocidin e ushtruar në Mitrovicë dhe rrethinë. Ishte dëshmitar i Tribunalit të Hagës në gjyqin kundër Millosheviqit dhe të 12 të akuzuarve serbë. Është autor i disa pjesëve teatrale dhe regjisor i shfaqjeve. (Ruzhdi Jashari)

BARDHI Frang (Frani i Bardhë, Franciscus Blancus) (1606-1643). Leksikograf, polemist, historian, klerik i lartë katolik. Lindi në Nënshat të Kallmetit të Zadrimës në një



FRANG BARDHI

familje klerikësh të lartë e me traditë lidhjesh me Venedikun. Studioi në Kolegjin Ilirik të Loretos, më vonë në Kolegjin Propaganda Fide në Romë, në Kolegjin e Urbanit. Më 1636 u emërua ipeshkëv i Ipeshkvive të Sapës dhe të Sardës. Nga viti 1637 ka dërguar raporte të regullta për gjendjen në Ipeshkvinë e tij italisht e latinisht në Propaganda Fide në Romë. Njihet si zbuluesi i veprës së Gjon Buzukut më 1743, të cilën ai e karakterizoi si “Mashar”. Frang Bardhi njihet

me veprën e tij apologjetike për Skënderbeun latinisht: “Gjergj Kastrioti i Epirit popullorçë Skënderbeu, Princ shumë i fuqishëm dhe i pathyeshëm i epirotëve”, Marco Ginammi, Venecie 1636, f. 76 (“Georgius Castriotus Epirensis vulgo Scanderbegh, Epirotarum Princeps fortissimus, ac inuictissimus Suis, & Patriae restitutus”, Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI. Superiorum permissu, & Priuilegio, 76 f.). Në të ai ka polemizuar me ipeshkvin boshnjak Joannes Tomcus Marnavitius (Marnaviq), i cili e lidhte Skënderbeun me familjen e tij. Në linjën e Barletit, libri i Bardhit ka interes, si për aspektet letrare ashtu për vërtetimet historiko-kritike. E shquan dashuria për atdheun, krenaria familjare. Si në relacionet, vlerësohen traditat shqiptare dhe shprehet dëshira e madhe për liri. Vlerësohet stili i shkathët i autorit në të shkruarit latinisht. Vepra është përkthyer dhe botuar shqip nga Stefan Prifti: Frang Bardhi, “Skënderbeu”, Tiranë, 1957. Fjalori “Dictionarium latino-epiroticum per R.D. Franciscum Blanchum” (Fjalor latinisht-epirotisht/ shqip), i vitit 1635, është ribotuar më 1932 nga Mario Roques. Përveç parathënies dhe shënimeve, botimi përmban tërë materialin e Fjalorit të Bardhit me fototipi. Një botim e ka bërë Engjëll Sedaj: Frang Bardhi, “Fjalor latinisht-shqip 1635”, Prishtinë, 1983, ku përfshihen shënime të ndryshme dhe indeksa. Më 2008 Bardhyl Demiraj në Shkodër ka bërë botimin kritik me shënime të reja biografike dhe konkordanca. Fjalori përfshin rreth 2,500 fjalë latine të përkthyer shqip. Në formë shpjegimi ndonjëherë jepen edhe fjalë italiane dhe turke. Fjalori përmban emra të ndryshëm vendesh, shprehje, elemente të veçanta gramatikore dhe 113 proverba shqip, që përbëjnë përmbledhjen e parë të folklorit shqiptar. Nga aspekti i grafisë Frang Bardhi ka ndjekur rrugën e Pjetër Budit me disa ndryshime. Në ortografi bien në sy lëkundje të vazhdueshme. (Rexhep Ismajli)

BARDHI Hamdi (1932-2007). Pikturor. Lindi në Prizren. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në Prizren, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Punoi si pedagog i artit figurativ në Rahovec dhe në Prizren. Ishte ndër anëtarët e parë të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), që nga viti 1965. Ekspozitat më të rëndësishme personale: në Prizren, Beograd, Leskovc, Mitrovicë, Prishtinë, Pejë, Gjirokastër, Shkodër,

Tiranë etj. Mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta në vend dhe në botë. Si anëtar i SHAFK-ut ekspozoi vazhdimisht në ekspozitat tradicionale: Salloni i Nëntorit, ekspozitat pranverore dhe vjeshtore, Bienalja Ndërkombëtare e Vizatimit etj. Ishte piktor inventiv dhe original. Njihet cikli i tij “Fasadat e Prizrenit”, i frymëzuar nga arkitektura e lashtë e qytetit të Prizrenit. Me këtë cikël dhe me peizazhet e Prizrenit H. Bardhi e rrumbullakësoi tërë opusin krijues, që në artet pamore të Kosovës e veçon si piktor i motiveve autoktone, origjinale. Hyn në radhën e krijuesve më të frytshëm dhe original. (Tahir Emra)

BARDHI Ker Sadri (1861-1941). Luftëtar i lëvizjes për pavarësi dhe për bashkim kombëtar. Lindi në Stankaj të Pejës. Pjesëmarrës në kuvende të krerëve të Kosovës dhe në luftime kundër forcave osmane që në vitet e fundit të shekullit XIX. Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912 u priu luftëtarëve rugovas në përbërje të grupimit të drejtuar nga Bajram Curri. Në vjeshtën e vitit 1912 ishte njëri ndër organizatorët e qëndresës kundër trupave malazeze që depërtuan në Rrafshin e Dukagjinit. Kundërshtoi konvertimin që e ushtronin me dhunë malazetët. Pavarësia e Shqipërisë e gjeti në Vlorë. Në vitet 1913-1915 u përfshi në organizimin e luftës kundër pushtimit malazias. Ishte anëtar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës për Plavë, Guci dhe Rugovë. Ishte njëri ndër organizatorët e kryengritjes së vitit 1919 në Kosovë. Në vitin 1920 ishte në mbrojtje të Koplikut. Bashkëpunoi pothuajse më të gjithë nacionalistët kosovarë në Shqipëri. Gjatë vitit 1922-1923 qëndroi në Zonën Neutrale të Junikut. Deri më 1924 udhëhoqi kryengritësit rugovas, së bashku me Sali Ramën e Rugovës. Në ballafaqimet politike të vitit 1921-1924 në Shqipëri u bashkua me forcat e Bajram Currit. Pas përmbysjes së qeverisë së Nolit dhe rikthimit të Zogut në pushtet u dënua me vdekje, por vendimi nuk u zbatua. Në vitin 1926 u vendos si emigrant në fshatin Gurëz e më vonë në Gorre, në afërsi të Milotit. U vra në vitin 1941 nga keqbërës ordinerë. (Lush Culaj).

BARDHI Mehdi (1927-1994). Gjuhëtar, profesor universiteti. Mësimet fillore i kreu në Prizren, ndërsa të mesme në Prishtinë. Ka studiuar për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd, ku është magjistruar me studimin mbi të folmen e Hasit.



MEHDI BARDHI

Ishte profesor i Shkollës së Naltë Pedagogjike dhe ligjërues në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e shkollimit të lartë dhe një kohë ishte anëtar i redaksive “Përparimi”, “Buletini i SHLP të Prishtinës”, “Buletini i Fakultetit të Filozofisë”, “Gjurmime Albanologjike”, “Studime Gjuhësore I - Dialektologji”, “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare” etj. Në vitet 1989/90 ishte lektor i gjuhës shqipe në Universitetin e Pekinit, ku përpiloi librin e gramatikës së gjuhës shqipe për studentët kinezë. Ishte bashkautor në hartimin e “Fjalorit serbokroatisht-shqip” (1974) dhe të “Fjalorit shqip-serbokroatisht” (1981) dhe bashkautor i “Fjalorit të fjalëve të huaja”. Bashkë me R. Ismajlin hartoi tekstin e mësimin të shqipes për të huajt (1974). Botoi artikuj për të folmen e Hasit, për të folmen e Peshterit etj. (Agnesa Hasimja)

BARDHI Mehmet (1947-). Politikan, mësimdhënës. Lindi në Kështenjë të Krajës, komuna e Tivarit, në Mal të Zi. Filloren e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mësuesisë në Ferizaj. Diplomoi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës më 1972. Disa vjet punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Ulqinit, deri në fund të vitit 1981, kur u përjashtua nga puna për shkaqe politike, për t’u dënua më vonë me dy vjet burg për “delikt verbal”. Në vitin 1990, pas shpalljes së sistemit shumëpartiak, bëhet njëri nga themeluesit dhe kryetar i partisë së parë politike të shqiptarëve në Mal të Zi, Lidhja Demokratike në Mal të Zi, e cila, po atë vit, në zgjedhjet e para lokale fitoi shumicën në Ulqin. M. Bardhi ishte kryetar i komunës së Ulqinit në periudhën 1992-1996 dhe kryesoi delegacionin e shqiptarëve të Malit të Zi në Konferencën e Paqes për ish-Jugosllavinë. Në vitet 1996-2012 ishte deputet i Kuvendit të Malit të Zi. (Ali Cenaj).



MEHMET BARDHI

BARDHI Ylber (1984-). Aktor. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2011). Luajti në një sërë shfaqjesh teatrore në teatrot e Kosovës. Është paraqitur në role kryesore në shfaqjet “Ëndrra e një nate vere” (2007), “Nata e dymbëdhjetë” (2012), “Kolonel Zogu” (2014), “Një kafkë në Konemara” (2014), “Tregtari i Venedikut” (2016) etj. Luajti edhe në një sërë filmash të shkurtër dhe seriale televizive, si në “Familja moderne” (2004), “O, sa mirë” (2013). U nderua me çmime dhe mirënjohje në festivale të teatrit shqiptar. (Visar Krusha)

BARE. Fshat në Shalën e Bajgorës, rreth 22 km në verilindje të Mitrovicës. Është vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë. Me këtë emër përmendet në defterin kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566 me 16 shtëpi. Sot fshati ka 168 shtëpi me 1,445 banorë. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe pylltari, kurse një numër i banorëve të fshatit punojnë në minierën e Trepçës. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore dhe të mesme, shtëpinë e kulturës, zyrën e vendit, stacionin shëndetësor, postën etj. (Skënder Halimi)


BARIQ (Barić) Henrik (1888-1957). Gjuhëtar kroat, albanist, profesor universiteti. Lindi në Dubrovnik, ndërsa studimet për gjuhësi krahasimtare dhe romanistikë e sllavistikë i ndoqi në Grac dhe në Vjenë që nga viti 1906, për t’u doktoruar më 1912. Punoi në Universitetin e Beogradit. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte profesor i Universitetit të Sarajevës. Më 1924 themeloi në Beograd Seminarin e albanologjisë, ndërsa më pas Institutin e Ballkanologjisë në Sarajevë. Është marrë me studimin e historisë së shqipes, me raportet e shqipes me rumanishten, me gjuhët e lashta të Ballkanit - ilirishte, trakishte dhe makedonishte. Kontribuoi për lidhjet e gjuhëve të vjetra dhe të reja në Ballkan, ku shqipja, për të, zë vend qendror. Botoi revistën “Arkivi për antikitetin shqiptar, gjuhën dhe etnologjinë” (Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, 1923-1926). Ka dhënë kontribut për shpjegimin e refleksëve të guturaleve të vjetra *ie*. Vepra e tij “Hymje në historinë e gjuhës shqipe” u botua në Prishtinë më 1955. Botoi edhe “Studime shqiptaro-rumune” (Älbanorumänische stu-

diuen I, 1919), “Studime gjuhësore ilire” (Ilirske jezičke studije I, 1948) etj. Punoi fjalorin e serbishtes e të kroatishtes dhe shqipes, por u botua vetëm një pjesë e tij (1950). Mbrojt i denë e prejardhjes trakase të shqipes. Shkroi për kronologjinë e zanoreve të shqipes dhe për huazimet e ndërsjella të gjuhëve ballkanike. (Bardh Rugova)

BARISHIQ (Barišić) Josip (1914-1993). Muzikant. Lindi në Amerikë. Pas kryerjes së shkollës fillore dhe vdekjes së babait u kthye në Zare (Kroaci). Shkollën e mesme ushtarake dhe Akademinë e Muzikës i kreu në Beograd, ku punoi si muzikant ushtarak. Më 1939 u dërgua me detyrë në Prizren, ku krijoi familje. Ishte përkrahës i Lorenc Antonit për themelimin e shkollës së muzikës dhe themelues i Orkestrës së Zjarrëfikësve të Qytetit, si punë vullnetare. Mori pjesë në organizimin e manifestimeve muzikore në Kosovë dhe jashtë, në përgatitjen e nxënësve të shkollës së muzikës për gara në ish- Jugosllavi, ku nxënësit e tij ktheheshin me suksese; konsultant i instrumentit të trumbetës në koncerte, si dhe fitues mirënjohjesh e medaljesh për kontributin në fushën e muzikës. Ligjëroi veglat me frymë në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren deri në pension. Vdiq e u varros në Prizren. (Rreze Kryeziu-Breznica)

BARJAKTAREVIQ (Bajraktarević) Danilo (1910-1988). Dialektolog serb. Lindi në Berane, në Mal të Zi. Studimet për sllavistikë i mbaroi në Shkup. Temën e doktoratës për të folmen e Novi Pazarit dhe të Sjenicës e mbrojt në vitin 1958 në Novi-Sad. Në vitin 1960 u zgjodh bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Gjuhës Serbe në Beograd. Ishte profesor dhe shef i katedrës së gjuhës serbe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe drejtor i Institutit për Gjuhë Serbe (1973-1976). Botoi vepra shkencore, ndër të cilat: “Të folmet e Novi Pazarit dhe të Sjenicës” (1966), “Të folmet e Bihorit” (1966), “Tipi i dialekteve të Kosovës” (1971), “Zona e të folmes së Preshevës dhe Bujanocit” (1966), “Veçoritë e të folmes së Gjilanit” (1977), “E folmja e serbëve të Dukagjinit” (1979), “Zhvillimi historik i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit” (1986). U mor me ndikimet dialektore midis gjuhëve serbe dhe shqipe. (Naile Mala-Imami)

BARLECI Marin (Marinus Barletius) (1450/60-1512/13). Historian dhe shkrimtar



MARIN BARLECI

arbëror i periudhës së humanizmit. Biografia e tij nuk është e njohur sa duhet. Me disa hollësi të jetës njihemi nga veprat e tij. Siç na thotë vetë në veprën “Rrethimi i Shkodrës”, M. Barleci ishte prift katolik nga Shkodra. Më 1474, në rrethimin e parë të Shkodrës nga osmanët, ai ndodhej në qytet si dëshmitar i ngjarjeve, ndërsa në rrethimin e dytë të Shkodrës (1478/1479) mori pjesë në luftime për mbrojtjen e qytetit. Me dorëzimin e qytetit (1479), M. Barleci, bashkë me gjithë qytetarët e tjerë (450 burra dhe 150 gra), sa kishin mbetur në Shkodër, kaloi në tokat e Republikës së Venedikut. Atje u bë i njohur në qarqet shkencore dhe letrare me veprat: “Rrethimi i Shkodrës” (1501/1504) (*De Obsidione Scodrensi*), “Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, princ i epirotëve” (1506/1510) (*Historia de vita et rebus gestis Scanderbegi Epirotarum principii*) dhe “Shënime të shkurtra të jetës së papëve dhe perandorëve” (1555) (*Compendium vitarum pontificum et imperatorum*). Dy veprat e para, me gjithë dobësitë tipike për historiografinë humaniste (imitimi i historianëve të antikitetit, pasaktësitë kronologjike, retorika e tepruar) konsiderohen dy monumente jo vetëm të Rilindjes Shqiptare, por edhe të asaj europiane. Zbulimet e reja arkivore në Arkivin Shtetëror të Padovës, në Arkivin Antik të Universitetit të Padovës, në Arkivin e Ipeshkëvisë së qytetit nga shek. XV-XVI kanë nxjerrë në dritë se M. Barleci ishte sistemuar mirë në Padovë e Venedik, ku ishte themeluar “Shkolla e arbërve” (1442) (*Scuola degli Albanesi*), e cila veproi plot dy shekuj e gjysmë. Përveç Padovës dhe Venedikut, supozohet se një pjesë të jetës e kaloi edhe në Romë, sepse këtu botoi edhe kryeveprën e tij. Studiuesit e sotëm, sikundër edhe të shek. XIX-XX, nuk kanë ofruar njoftime për krijimtarinë e M. Barleci në Padovë. Nga burimet arkivore bëhet e njohur se M. Barleci qe rektor i kishës parokiale “Shën Shtjefni” në Plovenara të Dioqezës së Padovës, si dhe abat në Kishën katedrale “Shën Justina” në Padovë. Këto poste, si dhe titulli doktor shkencash i diturive kanonike e teologjike, i kishin mundësuar të inkuadrohej plotësisht në veprimtarinë universitare të Padovës. (Jahja Drançolli)

BARNATORET (FARMACITË) NË KOSOVË. Institucione të kujdesit shëndetësor, të vendosura në mjedise të përshtatshme, ku bëhet përgatitja, ruajtja dhe shitja e barnave. Barnatoret e para në Kosovë u shfaqën në mesjetë, që punonin për spitale të manastireve. Përveç kësaj, tregtarët sillnin medikamente dhe barna mjekuese nga Italia, Ragusa apo nga qytetet e mëdha bizantine. Gjurmët e para të dokumentuara për zhvillimin e farmacisë në Kosovë i ndeshim në vitet 1339-1340, kur në Prishtinë përmendet farmacisti i shquar Zanini. Sipas disa të dhënave, gjatë viteve 1836-1856 në Prizren janë shitur ilaçe farmaceutike. Këtë detyrë e kryente Haxhi Durmishi. Farmacisti i parë më origjinë shqiptare ishte Halit bej Berzeshta i diplomuar në Stamboll. Farmacisti i parë i diplomuar në Kosovë ka qenë nga Prizreni, Mph. Radivojeviqi, i diplomuar gjithashtu në Stamboll (1906).

Barnatoret e para profesionale në Kosovë u inauguruan në vitin 1885 në Prizren dhe Prishtinë. Pronar i tyre ishte farmacisti Nikollaqi. Gjatë viteve 1917-1918 barnatore private kishte në Ferizaj, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë. Në vitin 1922 në Prishtinë u hap barnatorja e parë me një farmacist hebre. Në Gjakovë farmacisti Drag Trisha hapi barnatoren e parë (1925), në Pejë barnatorja parë u hap më 1926. Në Prizren përmenden Rifat Turtulla, i cili si i përndjekur politik në vitin 1945-1946 u shpërngul në Zagreb dhe një kohë të gjatë punoi në barnatoret e Zagrebit, pastaj Shefki Cufi, i cili ka punuar nga viti 1936, e më vonë e hasim në spitalin e Prizrenit, pastaj në barnatoren e Rahovecit, por edhe në shumë vende të tjera. Në Prishtinë po ashtu teknik i farmacisë ishte Nuredin Januzi, ndërsa në Gjakovë Abaz Manxhuka. Që nga viti 1945, në Kosovë vinin dhe shkonin farmacistë kryesisht nga Serbia dhe Vojvodina. Nga Kosova farmacisti i parë shqiptar i diplomuar ka qenë Mahmut Mahmuti nga Gjilani, i cili u diplomua në Fakultetin e Farmacisë në Beograd në vitin 1953. Fillimisht ai punoi në Gjilan dhe në vitin 1964 kaloi në Prishtinë, në postin e drejtorit të barnatoreve të Prishtinës e më vonë drejtor i barnatoreve të Kosovës. Më pas radhiten farmacistë të tjerë, si Shefqet Malushaga nga Peja, Sherafedin Mustafa nga Prishtina, Avni Zhubi nga Gjakova dhe një gjeneratë e mëvonshme farmacistësh të diplomuar në vitet '60. (Amir Agani)

BARTOLI Mateo (Bartoli Matteo) (1873-1946). Gjuhëtar italian. Doktoroi në Universitetin e Vjenës. Ishte profesor i universiteteve të Pisës dhe të Torinos. Vepra e tij kryesore është për dalmatishten (1906). Mbahet themelues i rrymës së gjuhësisë hapësinore (spaciale). Ishte mentor i N. Resulit dhe i A. Gramshit dhe ishte i pari që artikuloi idenë për hartimin e një atlasit dialektologjik të shqipës, për të cilin ai shkruante në “Buletin e atlasit gjuhësor italian” (Bolletino dell’Atlante linguistico italiano, 1933). Lidhur me këtë, më 1940 u formua një komitet ekzekutiv që përbëhej nga K. Merlo, M. Bartoli dhe K. Taliavini. Në fillim ai mendonte që mbledhjen e materialit t’ua besonte N. Resulit e Z. Skiroit, por më 1943 u vendos që këtë punë ta kryente E. Çabej. Projekti nuk u realizua për shkak të ndryshimeve politike në Shqipëri gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, por ai u mor parasysh kur u hartua “Atlasit dialektologjik i gjuhës shqipe” (2007-2008). (Shpëtim Elezi)

BASENI QYMYROR I DRENICËS. Hulumtimet gjeologjike në Drenicë nisën që në vitin 1955 dhe vazhduan gjatë vitit 1965, ndërsa më vonë, pas një pushimi të gjatë, vazhduan në vitin 1980. Sipërfaqja e basenit brenda kufirit gjeologjik është 3.9 km². Në aspektin gjeologjik, edhe këtu është krijuar vetëm një shtresë e qymyrit, e cila ka prirje të degëzimit. Shtresa e qymyrit ka ndërfutje të trasha të argjileve të zeza. Baseni i Drenicës përbëhet nga dy fusha qymyrore: fusha e Skënderajt dhe fusha Drenas-Gllobarit. Fusha qymyrore e Skënderajt është hulumtuar me 44 shpime, nga të cilat vetëm dy ishin negative, me gjatësi të përgjithshme 1,790 m. Me këto shpime u bë i mundur klasifikimi dhe kategorizimi i rezervave të qymyrit. Rezervat sipas kategorive “B” dhe “C₁” të vendburimit të Skënderajt janë 59.7x10⁶ tonë qymyre. Nga shpimet e kryera janë nxjerrë këto përfundime: trashësia mesatare e mbulesës 35 m; trashësia e përgjithshme e shtresës së qymyrit 58.3 m, kurse ajo e shfrytëzimit 53.3 m; trashësia e mbulesës në pjesën shfrytëzuese të qymyrit 31.4 m, kurse trashësia e shtresës së thjeshtë të qymyrit 26.7 m. Nga shtrembërimet ndasore veçohen dy shkarje diagonale (R₁ dhe R₂). Fuqizimi i kërcimeve ndryshon prej 10 deri 40 m, ndërsa shkarja (R₃) është dytësore. Në fushën e Skënderajt përfshihen ndodhjet në fushën e Polacit, në lagjen Velu dhe në Prekaz,

në lagjen Kodraliu, në lagjen e Lushtakëve dhe Mehaj. Në fushën e Drenasit përfshihen ndodhjet e fushës së Gllobarit, në Poklek dhe në Komoran. Sipërfaqja e rajonit të Drenicës është 1.5-20 km², ndërsa shtresa e qymyrit ka trashësi prej 8.7-18.8 m, ose mesatarja 8 m. Ndodhet në thellësi ndërmjet 8.70-81.70 m. (Minir Dushi)

BASENI QYMYROR I DUKAGJINIT. Baseni terciar i Dukagjinit paraqet një ultësirë tektonike me sipërfaqe rreth 1,700 km², që ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës. Në anën e majtë, buzë rrjedhjes së Drinit të Bardhë, ndërmjet lokaliteteve Klinë-Tuçepi, në një sipërfaqe prej mbi 120 km² janë zbuluar rezerva të mëdha të qymyrit linjit. Treva e vendburimit të qymyrit të Dukagjinit përbëhet nga dy zona: zona Klinë-Tuçepi me fushat e huluntuara (Klina “A”, “B”, dhe “C₁”, Tuçepi dhe Gusar) dhe zona në anën e djathtë të Drinit të Bardhë, më pak e huluntuar, që përfshin pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit. Zona e parë Klinë-Tuçepi ofron kushte më të mira për nxjerrjen e qymyrit (raporti industrial 4:1 m³/t), kurse kushtet në zonën e dytë janë të papërshtatshme, për shkak të vlerës së lartë të këtij raporti 8:1 m³. Në basenin e Dukagjinit, në sedimentet pontiniane gjeologjiksht është zhvilluar vetëm një shtresë e qymyrit, e cila ka ndërtim të koklavitur, me trashësi prej 30-50 m, rrallë herë më e madhe. Nga pikëpamja gjenetike, në materialin qymyror dallohen dy lloje të qymyrit, ksilite dhe humusike. Për nga vetitë fiziko-kimike, qymyri i fushës Klinë-Tuçepi ka ngjyrë të murrmë-të verdhë, me thyerje të parregullt. Kur thahet në ajër, lehtë humb lagështinë. Baseni i Dukagjinit për nga perspektiva nuk mbetet pas basenit të Fushë së Kosovës. Rezervat e përgjithshme gjeologjike të qymyrit janë vlerësuar në 2,8004x10⁶ në sipërfaqe prej 69.4 km². Ndarja e basenit të qymyrit sipas fushave të huluntuara (në 10⁶t) duket kështu: Fusha “Klina” 1,400.4; Fusha “A” 230; Fusha “B” dhe “C” 385.6; Fusha “Tuçepi” 152 dhe Fusha “Gusar” 266. Prodhueshmëria e basenit të Dukagjinit në të gjithë pjesën sipërfaqësore të huluntuar është 37.6 t/m². Vendburimi Klinë-Tuçepi përfshin pjesën veriore të basenit dhe shtrihet në anën e majtë të Drinit të Bardhë dhe ndërmjet Klinës në jug dhe Tuçepit. Kufijtë e vendburimit nuk janë mbyllur në përfundim dhe veriperëndim kah

vendburimet Istog dhe Gusar. Në pjesën jug-perëndimore të fushës “Klinë-Tuçepi” tektonika radiale nuk është hulumtuar mjaft, por është vërtetuar se kjo pjesë është ndërtim i thjeshtë tektonik. Shkarje me kërcime të mëdha nuk janë vërtetuar, por nga kërkimet e deritashme mendohet se fusha “Klinë-Tuçepi” është ndarë nga shkarjet në një numër më të madh ose të vogël blloqesh. Janë vërtetuar dy shkarje në pjesën veriore të basenit. Qymyrbajtja e basenit të Dukagjinit mbështetet vetëm në përfundimet e shpimeve kërkimore dhe të analizave laboratorike e të karrotave, pasi qymyri i këtij baseni nuk është shfrytëzuar ndonjëherë. Vendburime të rëndësishme të qymyrit në suazën e këtij baseni ndodhen edhe në rajonin Kijevë-Mleçan-Bubavec-Llashki Drenoc. Në këtë rajon punimet kërkimore të qymyrit janë zhvilluar në dy faza: në fazën I në vitin 1986 u hulumtua fusha qymyrore Klinë-Mleçan, me 25 shpime të thella prej 28.0-94.0 m. Nga këto shpime, 23 kanë kaluar shtresën e qymyrit me trashësi prej 12.0 deri 42.8 m, kurse trashësia e thjeshtë e qymyrit është 5.3-31.7 m. Trashësia e mbulesës sillet prej 6.0-47.6 m. Raporti shterp: qymyr vlera mesatare është 0,83:1 m³/t. Rezeruat e kategorive “B” dhe “C₁” janë 327,891,107 tonë, përmbajtja e hirit 12.25-27.90, kurse nxehtësia e ulët termike prej 4,890-8,025 kJ/kg. Në fazën II, hulumtimet e qymyrit të këtij rajoni ishin kryer në vitin 1987 në jug të Kijevës, në drejtimin Bubavec-Llashki Drenoc-Lubizhdë, ku janë kryer shpime të thella në gjatësi të përgjithshme prej 500 m. Në fushën qymyrore Kijevë-Mleçan-Bubavec-Llashki-Drenoc, në sipërfaqe 10 km², janë zbuluar rezerva të qymyrit “B”+“C₁”+“C₂” 582,117,614 tonë. Rezeruat e kësaj treve janë gjithsej rreth 800 milionë tonë. (Minir Dushi).

BASENI QYMYROR I FUSHËS SË KOSOVËS. Baseni i Pliocenit të Fushës së Kosovës është një luginë e gjatë 85 km dhe e gjerë 10 km. Shtrihet në drejtimin veri-veriperëndim - jug-juglindje, prej Mitrovicës në veri deri në Kaçanik në jug. Baseni zë një sipërfaqe prej rreth 850 km², ndërsa sipërfaqja qymyrbajtëse e tij është rreth 300 km². Nëpër mes të basenit rrjedh lumi Sitnica, i cili kryen kullimin e të gjithë ujërave të këtij baseni. Baseni i Fushës së Kosovës është një rrafsh i valëzuar, i rrethuar shprehimisht me mjaft male, me rënie të butë nga jugu në veri.



MIHJA SIPËRFAQËSORE E QYMYRIT, BARDH I MADH

Nxjerrja e qymyrit (linjit) të këtij baseni për herë të parë ishte kryer në mënyrë nëntokësore në vendin Palaj (1921). Hulumtimet e para sistematike të qymyrit në basenin e FK ishin kryer vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, në vitet 1952-1957. Atëbotë bëheshin përgatitje për kalimin nga nxjerrja nëntokësore e qymyrit me atë sipërfaqësore. Ishte studiuar mundësia e nxjerrjes në masë të qymyrit për djegie “in situ” (në vend) në termocentrale për prodhimin e energjisë elektrike dhe të përpunimit industrial të qymyrit (terja, gazifikimi, briketimi, prodhimi i gjysmëkoksit dhe industrisë kimike). Qymyri i Kosovës ka ngjyrë kafe të errët, është linjit i butë, me sasi të madhe ksilite (80%). Mesatarisht përmban 40-45% lagështi, rreth 15% hi (herë-herë deri 25%), sqfur 1.0% dhe efekte termike të ulëta (ETU) prej 5,750-10,300 kJ/kg. Në gjysmën e shekullit XX baseni qymror i Fushës së Kosovës ishte objekt i shumë hulumtimeve të hollësishme gjeologjike kur ishte caktuar shtrirja dhe trashësia e qymyrit, trashësia e mbulesës së tokës (shterpës), kurse me studime dhe analiza kimike-teknologjike ishte vërtetuar cilësia e qymyrit. Në sipërfaqen e basenit të Fushës së Kosovës hyjnë minierat sipërfaqësore Mirash, Bardh dhe Sibofc (pjesa veriore), Lipjan dhe Babushi i Muhaxherëve (pjesa jugore). Si pasojë e veprimeve tektonike, shtresa e qymyrit është shumë e ndërlikuar, sepse shkarjet janë të drejtimeve të ndryshme. Kjo ka kushtëzuar ndërtimin parketor të vendburimit. Në basenin qymror të Fushës së Kosovës ndodhet vetëm një shtresë e qymyrit, trashësia mesatare e së cilës për gjithë fushën sillet 50-60 m, kurse ajo e mbulesës 60 m. Raporti i mbulesës ndaj shtresës së qymyrit është i përshtatshëm për

shfrytëzim sipërfaqësor. Së këndejmi, rëndësia ekonomike e kësaj fushe është e madhe. Koeficienti industrial i zbulimit për tërë basenin është 1,84:1 m³/t. Një raport i këtillë është shumë i rrallë në vendburimet qymyrore të botës. Shtresa e qymyrit ka shtrirje afërsisht horizontale me pak çrregullime tektonike. Baseni i Fushës së Kosovës është një ndër basenet e mëdha që janë zbuluar në rajonin juglindor të Europës. Për nga cilësia, qymyri nuk është gjithmonë i mirë, gjë që tregon se qymyri nuk është krijuar në kushte të mira të një karbonizimi të plotë dhe të përpiktë. Krijimet që mbulojnë qymyrimin, në rastet më të mira, janë të ndërhuara nga argjilet me trashësi prej 10-200 m. Argjilet në vete nuk përmbajnë akumulime të mëdha të ujit, që domethënë se nuk ekziston rreziku nga vërshimet gjatë nxjerrjes së qymyrit.

Në vitin 1975, në ish-kombinatit "Kosova" në prodhim ishin këto objekte industriale: 1) Miniera Mirash me aftësi 4.5x10⁶ t. qymyr; 2) Miniera në Bardh me aftësi prodhuese 5.5x10⁶ t. qymyr. Pas përfundimit të hulumtimeve gjeologjike (1952-1957), në basenin qymyror të Fushës së Kosovës janë vërtetuar këto rezerva të përgjithshme: $A+B+C_1+C_2 = 6.376 \times 10^6$ t. Në rezerva janë llogaritur vetëm pjesët e qymyrit me aftësi termike prej 5,860-7,360 kJ/kg. me përmbajtje të hirit deri në 20% dhe të lagështisë 45-50%. Qymyri me ETU nën 5,860 kJ/kg nuk është marrë parasysh për shfrytëzim. Ndërkaq, Instituti i Xehetarisë në Beograd, duke studiuar ndarjen e basenit të Fushës së Kosovës në fusha të shfrytëzimit, ka llogaritur rezervat e përgjithshme të qymyrit të këtij baseni prej gjithsej: $A+B+C_1 = 11.759 \times 10^6$ t. Në këtë rast për llogaritjen e rezervave ishte marrë sipërfaqja e përgjithshme prodhuese e shtresës së qymyrit prej 264 km², ndërsa në vlerësimet e mëparshme të rezervave kjo sipërfaqe ishte 154 km². Nga minierat sipërfaqësore për të tri fushat (e Sibofcit, e fushës jugore dhe e fushës D) ishte planifikuar prodhimi vjetor prej 16.24 x 10⁶ t qymyr, duke filluar nga viti 2011. (Minir Dushi)

BASHA Doruntina (1981-). Dramaturge, skenariste. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Kreu studimet për dramaturgji në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2004), ndërkaq studimet master i vijoi në Britani, Itali dhe Francë. Është autore dhe bashkautore e disa dramave:

"Udhëtim në Unmikistan" (bashkautore, 2003), "Mësimi i ndaluar" (bashkautore, 2004), "Dimri më i gjatë" (bashkautore, 2005), "Shpuza dhe thupra" (2005), "Zërat" (2005), "Gjithçka 1.5" (2005), "Gishti" (2011) etj. Dramat e saj janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, ndërsa janë botuar në Kosovë, Francë, Turqi, Angli etj. Dramat e saj janë inskenuar në Teatrin "Dodona", në Teatrin "Oda" dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, pastaj në Qendrën Teatrorë për Fëmijë në Shkup, në Teatrin Bifex në Beograd (Serbi), në Teatrin "Sartr" në Sarajevë, si dhe në Teatrin Hundsturm-Volkstheater në Vjenë. Është skenariste e disa filmave të metrazhit të shkurtër dhe e një filmi të metrazhit të gjatë. Punoi si asistente e regjisë në disa projekte filmike, si dhe në televizion. Si përkthyesë solli nga anglishtja në shqip disa drama bashkëkohore. Drama e saj "Gishti" mori çmimin e parë në konkursin për dramë bashkëkohore nga Ballkani Perëndimor të Fondit "Heartefact" (Beograd, 2011) dhe "Kurorën e artë" si drama më e mirë bashkëkohore nga Ballkani në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit "MESS" (Sarajevë, 2013). (Bekim Lumi)

BASHA Eqrem (1948-). Poet, romancier, tregimtar, përkthyes, akademik. Lindi në Dibër, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studioi albanologjinë në Prishtinë. Punoi si gazetar te



EQREM BASHA

"Bota e re", në gazetën "Rilindja" dhe në javoren "Koha". Në Televizionin e Prishtinës ishte redaktor i dramës dhe redaktor përgjegjës i programit kulturor-artistik. Është nga themeluesit dhe redaktor përgjegjës i Shtëpisë Botuese "Dukagjini". Botoi veprat: "Shëtitje nëpër mjegull" (1971), "Opuset e maestros" (1971), "Stacionet e fisnikëve" (1972), "Polip-ptikon" (1974), "Yjedet" (1977), "Mëngjesi i një pasditeje" (1978), "Atleti i ëndrrave të bardha" (1982), "Udhë qumështore" (1986), "Brymë në zemër" (1989), "Marshi i kërmillit" (1994), "Zogu i zi" (1995), "Shtëpia e mallit" (2009), "Dyert e heshtjes" (2001), "Alpinisti" (2004), "Lakorja e ik-sit" (2011), "Varrë" (2013). Botoi disa libra me poezi të zgjedhur. Shkroi skenarë filmi, artistikë e televizivë, radiodrama, tekste të shkurtra dramatike dhe u mor me ese e kritikë arti.

Më 1999 botuesi frëng "Fayard" nxori librin me tregime të zgjedhura "Hijet e natës" (Les ombres de la nuit). Libra të tij të poezisë u botuan në serbisht (Prishtinë), polonisht (Seyni), anglisht (Nju-Jork), frëngjisht (Montelimar dhe esperanto (Swidnik). Romani "Alpinisti" u përkthye në anglisht dhe në maqedonisht. Tregimet dhe esetë u botuan në gjuhë të ndryshme. Në festivale poezie, panairë libri e manifestime të tjera kulturore është paraqitur në mbrëmje autoriale, debate e performanca artistike. Është marrë me përkthime nga gjuha frënge (Malraux, Dib, Ionesco, Sartre, Camus, Beckett, Lévi-Strauss etj.), nga italishtja dhe gjuhët sllave. Ka botuar një antologji të teatrit frëng të shekullit XX. Ka marrë disa çmime të rëndësishme për letërsi, midis të cilëve edhe atë për vepër jetësore që ndan MKRS e Kosovës. Krijimtaria letrare e E. Bashës është gjurmë e shqetësimeve të ambientit tonë gjatë harkut kohor që shënon vepra e tij, të vesuar me një dozë absurdi. Veçanti e njohur e natyrës së tij krijuese është spontaniteti dhe natyrshmëria, me të cilën zotëron mundësitë zhanrore në krijimtarinë letrare: edhe në poezi, edhe në roman, edhe në prozën tregimtare është zë i vetvetes. I tillë është edhe në eseistikë, veçmas te persiatjet nga artet pamore. Edhe pse poezia tenton të ecë nga e përgjithshmja drejt personale, duke e gdhendur dhe ngjeshur lëndën e duke e ngushtuar kornizën e vendosjes së saj, ndërsa proza në drejtim të kundërt, në botën krijuese të E. Bashës të dy zërat qëndrojnë pranë e pranë dhe spontanisht e natyrshëm derdhen te njëri-tjetri. Është laureat i një sërë çmimesh letrare. (Ali Aliu)

BASHA Hafiz Safet (1920-1987). Titullar i fesë islame. Lindi në Prizren, ku kreu edhe shkollën fillore dhe si 14-vjeçar mori titullin hafiz. Kreu Medresenë "Mehmed Pasha" po në Prizren (1943). Pas diplomimit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë Etnike në Tiranë e caktoi imam në Xhaminë e Budak Hoçës. Më pas punoi në disa xhami të qytetit të Prizrenit. Më 1959 u emërua kryeimam, e nga viti 1969 kryetar i Bashkësisë Islame në Prizren. Më 1976 u emërua ushtrues detyre, kurse më 1981 myfti i rajonit të Prizrenit. Mbajti ligjëratat publike nëpër xhami në tri gjuhë: shqip, turqisht dhe boshnjakisht. Disa nga ligjëratat e tij u botuan në periodikun fetar. Ishte nismëtar i formimit të bibliotekës së Bashkësisë Islame në Prizren. (Nexhat Ibrahim)

BASHA Halit (1933-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Tiranë. Kreu shkollimin fillor në Dibër, Normalen në Shkup. Në Prishtinë studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe. Punoi disa vjet në arsim, pastaj në Pallatin e Kulturës në Dibër dhe në gazetari. Një kohë ishte korrespondent i "Rilindjes" nga Dibra. Tekstet e para letrare i botoi në "Flaka e vëllazërimit" nga viti 1953. Botoi gjashtë vëllime me poezi për të rritur dhe dy për fëmijë: "Lapidarë të vendlindjes" (1981), "Vargu im i vogël" (1998), "Flutura në pëllëmbë" (2002), "Ëndrra e zhgjëndrra" (2005), "Ditar në trotuar" (2006), "Stinë jete" (2008), "Ndalë pak orë" (2010), "Lirikë pleqërishte" (2014). (Fatmir Sulejmani)

BASHA Tefik (1947-). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Koretin (komuna e Kamenicës), ku e kreu shkollën fillore. Shkollën normale e mbaroi në Gjiilan në vitin 1966, ndërsa u diplomua në degën e gjeografisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1971). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Beogradit në vitin 1974, ku edhe e mbrojti tezën e doktoratës (1983). Një kohë të shkurtër punoi si asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ndërsa në vitin 1977 punësohet në degën e gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës. Në këtë degë ligjëroi disa lëndë, kryesisht nga gjeografia e vendbanimeve dhe gjeografia shoqërore. Disa vjet ka qenë kryeredaktor i revistës "Kërkime gjeografike" Ka botuar një numër punimesh shkencore, profesionale, trajtesa dhe vështrime për çështje të ndryshme gjeopopullative dhe të vendbanimeve. (Shpend Agaj)

BASHÇAREVIQ Lubisha (Baščarević Ljubiša) (1938-). Mjek ortoped, profesor universiteti. Lindi në Gjurakocv të Istogut, shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Prishtinë, kurse studimet për mjekësi në Universitetin e Shkupit. U punësua në repartin kirurgjik të Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë. Kreu specializimin për ortopedi dhe traumatologji në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit (1978). U emërua asistent për lëndën e kirurgjisë (1974) dhe më pastaj u bë docent dhe profesor i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Kreu studime pasdoktorale në Pragë

dhe në Moskë. Në vitin 1994 u emërua drejtor Klinikës Ortopedike, në periudhën e masave të dhunshme serbe. Ka botuar punime shkencore, disa monografi dhe tekste universitare. (Cen Bytyçi)

BASHKËHARTIMI LIGJOR VENDOR-NDËRKOMBËTAR (1999-2007). Proces ligjhartues pas luftës në Kosovë, nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së. Me këtë proces legjislativ unik u tejkalua vakuumi pas largimit të pushtimit serb të Kosovës dhe para pavarësisë së saj. Pas vendosjes së UNMIK-ut, në Kosovë u shfaq problemi i ligjeve të zbatueshme. Zyra ligjore e OKB-së në Nju-Jork, në territoret që i administronte, kishte zbatuar “ligjin e fundit në fuqi”. Në rastin e Kosovës kjo nënkuptonte mbajtjen në fuqi të ligjeve diskriminuese të pushtetit serb. Populli i Kosovës nuk do ta pranonte një zgjidhje të tillë, sepse sistemi i drejtësisë i vendosur së fundi nga Serbia në Kosovë konsiderohej sistem juridik pushtues. Me rregulloren e UNMIK-ut 1/1999 Kombet e Bashkuara aplikuan pikërisht këtë qasje, që “në Kosovë do të zbatohet ligji që ishte në fuqi deri më 23 mars 1999”. Kjo ngjalli reagime në tërë shoqërinë kosovare. Gjyqtarët dhe prokurorët e parë shqiptarë të emëruar nga UNMIK-u dhanë dorëheqje dhe i tërë sistemi juridik i UNMIK-ut ishte vënë në dyshim. Si rrugëdalje, Përfaqësuesi Special i OKB-së, Bernard Kushner, formoi Këshillin e Përbashkët Këshillëdhënës për Çështje Ligjore, të përbërë nga ekspertë ligjorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Këshilli filloi procesin e bashkëhartimit të legjislationit të ri, sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare. Gjatë këtij procesi të aplikuar për herë të parë nga OKB-ja, u hartuan Kodi penal i Kosovës, Kodi i procedurës penale etj. Por në dhjetor të vitit 1999, Përfaqësuesi Special i OKB-së nënshkroi rregulloren e UNMIK-ut 24/1999, me të cilën ligji i aplikueshëm në Kosovë do të ishte “ligji që ishte në fuqi deri më 23 mars 1989”, pra ligji i KSA të Kosovës, deri në ditën kur nga ana e Serbisë ishte suprimuar autonomia. Me këtë veprim Kombet e Bashkuara pranuan gjendjen juridike para asaj që ishte vendosur nga pushtimi serb. Më vonë kjo përvojë unike e Kombeve të Bashkuara në Kosovë do të rekomandohej si model i OKB-së për territoret e tjera nën administrimin e saj. Bashkëhartimi legjislativ nën UNMIK-un vazhdoi deri në

shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. (Blerim Reka)

BASHKËJETESA. Si formë e marrëdhënies në çift bashkëjetesa në kohën e fundit është shprehja më e dukshme e proceseve të çlirimit të gruas dhe i zhvillimeve shoqëror në këtë drejtim. Bashkëjetesa ka sjellë ndryshime dramatike në raportet intime dhe të dashurisë në gjithë botën. Shumë të rinj e ndajnë hapësirën e banimit dhe të mirat materiale pa qenë të fejuar, të martuar apo të kurorëzuar. Në bashkëjetesë zhvillohet jeta intime dhe seksuale si në martesë, funksionojnë marrëdhënia dhe marrëveshja ndërmjet dy personave që jetojnë bashkë, me role të caktuara martesore, por pa miratim social dhe zyrtar. Bashkëjetesa pra, duhet nënkuptuar si jetë në çift, marrëdhënie martesore të peregjistruara dhe të paformalizuara. Kjo formë e organizimit të jetës, si në rrafshin global, ashtu edhe në Kosovë, ka tendencë të vazhdueshme të shtrirjes edhe nëpër qendra më të vogla urbane. Çiftet vendosin të bashkëjetojnë të pamartuar për arsye të ndryshme. Disa e vënë vetën në sprovë të adaptimit, e disa të tjerë e konsiderojnë martesën si institucion të tejkaluar dhe të panevojshëm. Çiftet që bashkëjetojnë i nënshtrohen shumicës absolute të obligimeve ligjore, njëjtë si çiftet e kurorëzuara (obligimeve ndaj fëmijëve, të drejtës së trashëgimisë në pronën që krijohet gjatë periudhës së bashkëjetesës). Shumë shoqëri dhe kultura bashkëjetesën e konsiderojnë të papranueshme duke favorizuar vetëm martesën e miratuar dhe të legjitimuar me ligje pozitive, duke besuar se vetëm kjo formë e garanton dhe ruan stabilitetin e familjes. Ligjet pozitive në Kosovë e njohin bashkëjetesën dhe e trajtojnë si formë legjitime të jetës në çift, e njohin dhe e stimulojnë barazinë e çiftit dhe i precizojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Mirëpo edhe pse bashkëjetesa në Kosovë ka tendencë të masovizimit, martesë vazhdon ta dominojë skenën familjare. (Vjollca Krasniqi)

BASHKËPUNIMI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS ME UNIVERSITETIN E TIRANËS. Bashkëpunim 10-vjeçar i dy universiteteve, i cili përfshiu angazhimin e pedagogëve të Universitetit të Tiranës (UT) për mbajtjen e ligjëratave nga një sërë lëndesh për studentët e Universitetit të Prishtinës (UP), si dhe botimin e një numri tekstesh të UT-së në tirazh të

mjaftueshëm edhe për nevojat e studentëve të UP-së. Bashkëpunimi midis dy universiteteve ka filluar pas nënshkrimit të protokollit të parë për vitin shkollor 1970/71. Bisedimet për bashkëpunimin ndërmjet dy universiteteve u zhvilluan në korrik të vitit 1970, ndërsa protokoli u nënshkrua në shtator të po atij viti. Kontribut të veçantë për arritjen e mbarëvajtjes dhe realizimin e protokollit të bashkëpunimit dha në vazhdimësi prorektori i UT-së, Osman Kraja. Përveç ligjëratave dhe teksteve protokoli përfshinte edhe bashkëpunimin shkencor, ngritjen dhe specializimin e kuadrit, realizimin e programeve të përbashkëta shkencore, ekspeditat shkencore në terren për hulumtime arkivore dhe bibliografike, hartimin e fjalorëve terminologjikë etj. Deri në vitin 1981 bashkëpunimi ishte intensiv dhe përmbytësor, ndërsa u ndërpre në mënyrë të njëanshme nga ish-Jugosllavia pas demonstratave të marsit dhe të prillit të atij viti në Kosovë.

Gjatë periudhës dhjetëvjeçare një numër i pedagogëve të UT-së me ligjëratat dhe konsulencën e tyre shkencore dhanë kontribut të çmuar në ngritjen e kuadrit shkencor dhe përgjithësisht në zhvillimin e UP-së. Kontribut i veçantë i këtij bashkëpunimi ishte mbajtja e mësimit në gjuhë shqipe nga disa lëndë deficitare, për të cilat Kosova në atë periudhë nuk kishte kuadër të specializuar. Pedagogë e UT-së brenda një viti shkollor kanë mbajtur mesatarisht 23 lëndë mësimore me studentët e rregullt. Numri më i madh i ligjëratave ishin nga gjuha dhe letërsia shqipe, pastaj nga lëmi i shkencave teknike, nga shkencat matematiko-natyrore, nga mjekësia, artet etj. Për studime të rregullta dhe pasuniversitare në UP kanë mbajtur ligjëratat akademike dhe profesorë, emra të shquar të shkencës nga Shqipëria, nga të cilët veçohen, nga shkencat matematike-natyrore: Kolë Popa, Sotir Kuneshka, Petraq Pilika, Aleko Minga, Rexhep Mejdani, Skënder Gjinushi etj.; nga shkencat teknike: Bardhyl Golemi, Piro Cipo, Reis Çani, Ali Dedej, Naum Xhoxhi, Luan Voshtina, Ismail Demneri, Pullumb Karaulli, Fehmi Shehu, Burhan Jukniu, Hajredin Shtino, Haxhi Sauku, Bashkim Baholli, Sortir Guxho, Besnik Ostrosi, Iljaz Nako, Pandi Stratoberdha, Nikolla Verdha etj.; pastaj nga fusha e mjekësisë: Pëllumb Bitri, Fatos Harito, Shyqri Subashi, Shahin Kadare, Petrir Kokalari, Gjergj Minga etj.; nga fushat filologjike, nga historia dhe nga shkencat shoqërore: Eqrem Çabej,

Aleks Buda, Androkli Kostallari, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Stefanaq Pollo, Zija Xholi, Selami Pulaha, Kristo Frashëri, Andromaqi Gjergji, Myzafer Korkuti, Skënder Anamali, Luan Omari, Arben Puto, Bedri Dedja, Halil Sykja, Mevlan Kabo etj. (Minir Dushi)

BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (BIRK). Institucioni i vetëm dhe kryesor për besimtarët myslimanë në territorin Kosovës dhe të Luginës së Preshevës. Bashkësia



SELIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Islame organizon dhe promovon jetën fetare islame për besimtarët myslimanë në Kosovë dhe përmes këshillave të Bashkësisë Islame edhe në Luginën e Preshevës. Organizimi i jetës fetare islame në Kosovë zë fill që nga koha e administrimit të Perandorisë Osmane në këto anë. Me shkuarjen e Perandorisë Osmane nga trojet shqiptare, pra dhe nga Kosova, krijohen rrethana të reja shoqërore-politike. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Bashkësia e Fesë Islame, në kuadër të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, ka qenë e organizuar në atë mënyrë që myslimanët e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Slllovenisë kanë pasur një bashkësi në krye me Reis-ul-ulemanë me seli në Sarajevë, ndërsa myslimanët në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe në Mal të Zi kanë pasur bashkësinë e veçantë në krye me myftiun suprem me seli në Beograd. Pas 6 janarit të vitit 1929 Kosova do të kalojë në vartësi të Ulema Mexhllisit të sapoformuar në Shkup, që së bashku me Ulema Mexhllisin e Sarajevës, përbënin Rijasetin e Bashkësisë Islame me seli në Sarajevë. Gjatë periudhës 1941-1944, Bashkësia e Fesë Islame e Kosovës me dy kryemyftinitë e saj (kryemyftininë e Prizrenit dhe kryemyftininë e Prishtinës) do

të lidhej me Komunitetin Mysliman Shqiptar me qendër në Tiranë. Organizimi i saj ishte i ndarë në Kryemyftini dhe Nënmyftini. Në këtë kohë në Kosovë, në mënyrë të lirë dhe haptazi, shpërndahej literatura islame nga Shqipëria. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pas përfshirjes së Kosovës nën administrimin jugosllav, edhe Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë detyrimisht do të ndryshojë qendrën nga Tirana në Sarajevë dhe që nga viti 1945 e deri më 1990 do të veprojë si Bashkësia e Fesë Islame për Serbinë, përkatësisht për Kosovën, Serbinë dhe Vojvodinën, me seli në Prishtinë, në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të Federatës Jugosllave me qendër në Sarajevë. Fillimi i viteve '90 shënon një etapë të re për Kosovën. Në këtë periudhë, pas përgatitjeve të duhura, institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës, përkatësisht Kuvendi i saj, më 11 dhjetor 1993 vendosën të shkëputen nga Rijaseti i deriatëhershëm dhe të shpallin Bashkësinë Islame të Kosovës të pavarur dhe të mëvetësishme. Organizimi i Bashkësisë Islame të Kosovës filloi përmes xhemateve, të cilët përbëjnë këshillin e xhematit të një xhamie të caktuar. Këshillat e xhematit janë në vartësi të këshillave të Bashkësisë Islame. Këshill i Bashkësisë Islame, ndërkaq, është institucion bazë dhe kompetent për organizimin e jetës fetare në nivel lokal. Bashkësia Islame e Kosovës ka gjithsej 28 këshilla në 8 rajone. Bashkësia Islame e Kosovës ka simbolet e saja identifikuese, ka stemën dhe flamurin. Ajo udhëhiqet nga myftiu i BIK-ut, i cili është autoriteti më i lartë fetar në vend. Selia e Bashkësisë Islame të Kosovës është në Prishtinë. (Ramadan Shkodra)

BASHKËSITË RREGULLTARE KATOLIKE NË KOSOVË. Në Kosovë veprojnë bashkësi rregulltare katolike të meshkujve dhe femrave. Bashkësi rregulltare të meshkujve janë françeskanët, të cilët veprojnë në Gjakovë dhe salezianët, që veprojnë në Prishtinë dhe Gjilan. Derisa françeskanët i përkushtohen kryesisht shërbimit nëpër famulli, salezianët, të njoftur edhe si rregulli i Don Boskos, kryesisht i përkushtohen edukimit dhe formimit të brezit të ri. Në vitet e fundit ka filluar të veprojë edhe Rregulli i Shoqërisë Jezui, të njohur si jezuitë, që veprojnë me shkollën e tyre të njohur, gjimnazin "Loyola" në Prizren. Nga bashkësitë rregulltare femërore, në Kosovë veprojnë motrat françeskane

të Zojës së Papërlyer në Velezhë, Zym, Pjetërshan, Prizren dhe në Budisalc; pastaj Bijat e Dashurisë Hyjnore në Binçë, Ferizaj dhe Doblibare; Motrat e Shën Kryqit në Prishtinë, Gjakovë (famulli dhe kuvend); Motrat e Shën Palit-Engjëlloret në Prishtinë dhe Prizren; Motrat e Shën Filip Nerit në Potërc; Motrat e Shën Bazilit në Bec; Bijat e Dashurisë së krishterë-Vincencianet në Stubëll, Letnicë, Prishtinë, Glogjan, Klinë, Zllakuqan dhe Pejë dhe Motrat Misionaret e Dashurisë apo Motrat e Nënë Terezës në Pejë. Motrat e nderit kryesisht veprojnë nëpër famullitë e tyre dhe, përveç punës pastorale, në shumicën e vendeve kryejnë edhe shërbime sociale dhe mjekësore. (Vilson D. Marku)

BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM (BDI). Parti politike e shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë. U themelua në qershor të vitit 2002, pas shpërbërjes më 26 shtator 2001 të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Bërthamën e partisë së re e përbënin ish-ushtarët që luftuan nga marsi deri në shtator të vitit 2001 kundër ushtrisë së Maqedonisë. Me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13 gusht 2001, ish-ushtarët e UÇK-së u inkuadruan në jetën politike të vendit. Prej themelimit, kryetar i partisë u zgjodh Ali Ahmeti, nën drejtimin e të cilit BDI-ja i fitoi të gjitha zgjedhjet parlamentare në Maqedoni (2002-2014). Me përjashtim të periudhës 2006-2008, kur ishte opozitë, BDI-ja ishte në të gjitha koalicionet qeverisëse të Republikës së Maqedonisë: me LSDM-në (2002-2006) dhe me VMRO-DPMN-në (2008-2015). Në zgjedhjet e fundit parlamentare të 27 prillit 2014, BDI-ja fitoi numrin rekord të votave, që një parti politike shqiptare i fitoi ndonjëherë në Republikën e Maqedonisë, rreth 145 mijë vota. BDI-ja i fitoi edhe zgjedhjet lokale, duke marrë qeverisjen e komunave më të mëdha shqiptare, Çairin në Shkup, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Kërçovën, Likovën etj. (Blerim Reka)

BASHKIMI EUROPIAN. Union ekonomik dhe politik i 28 vendeve europiane, bazuar në idenë e Zhan Monetit, ministri i Jashtëm francez. Robert Shuman (ish-kryeministër i Francës) më 9 maj të vitit 1950 propozoi krijimin e Komunitetit të Thëngjillit dhe të Çelikut. Në vitin 1951 Gjermania, Franca, Belgjika, Italia, Luksemburgu dhe Holanda iu bashkuan këtij komuniteti. Shumë vjet më vonë, më



EMBLEMA E BE-SË

1991, Këshilli i Europës në Mastriht (Holandë) adaptoi marrëveshjen për Unionin European, e cila krijon bazat për politikë të jashtme të përbashkët, për politikë të sigurisë së përbashkët, për krijimin e unionit monetar e ekonomik

dhe të valutës së përbashkët. Institucionet kryesore vendimmarrëse të Bashkimit European janë: Parlamenti European, Këshilli European, Komisioni European, Banka Qendrore Europiane, Banka Europiane e Investimeve, Këshilli i Rajoneve, Ombudspersoni etj. Strukturat institucionale të BE-së gjenden në procesin e vazhdueshëm të reformimit. Kjo ndodh për shkak të integritetit të vazhdueshëm të vendeve të reja në BE, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri institucionale dhe funksionim efikas i vendeve të ndryshme brenda kësaj strukture të përbashkët. Një sfidë të veçantë për BE-në paraqet integrimi i Ballkanit Perëndimor, sepse ky zgjerim është më kompleks se çdo zgjerim i mëhershëm, duke pasur parasysh të kaluarën historike të vendeve të këtij rajoni. Edhe Kosova e ka si vizion integrimin në Bashkimin European, pasi kjo agjendë siguron mbështetje për reformat institucionale, financiare, ekonomike, për liberalizim të tregut, si dhe për konsolidimin e demokracisë dhe të legjislacionit në përputhje me standardet europiane. Për zbatimin e këtyre reformave Bashkimi European ofron mbështetje financiare si për vendet anëtare, ashtu edhe për vendet candidate dhe kandidatët potencialë. Në vitin 2016 Kosova ka bërë një hap të rëndësishëm në proceset e integritetit, duke nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim, i cili është dokumenti i parë kontraktual i Kosovës me BE-në. (Gazmend Qorraj)

BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS (BSPK). Organizatë sindikale e Kosovës, e themeluar më 1990, si organizatë e sindikatave vullnetarisht të anëtarësuara, me qëllim të mbrojtjes dhe të realizimit të të drejtave dhe lirive sindikale të anëtarëve të tyre. Gjatë viteve '90 BSPK-ja ishte pjesë e rezistencës së organizuar kundër pushtetit serb dhe u angazhua për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nga diskriminimi. Pas luftës BSPK-ja u ristruk-

turua në organizatë sindikale bashkëkohore, që merret ekskluzivisht me funksionin e saj themelor, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Këto funksione i realizon përmes një anëtarësie të gjerë dhe organeve përkatëse në strukturën e saj organizative, siç janë kongresi, këshilli drejtues, kryesia ekzekutive dhe kryetari. BSPK-ja ka aktet normative në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin përkatës për organizimin sindikal në Kosovë. Ajo e zhvillon veprimtarinë e vet në mënyrë të pavarur nga Qeveria dhe institucionet e tjera të Kosovës. BSPK-ja angazhohet për realizimin e marrëveshjeve kolektive, për sigurinë materiale, sociale dhe juridike, për kushtet e punës dhe të jetës dhe për nevoja të tjera të të punësuarve, për mbrojtje nga diskriminimi nëpërmjet aksioneve sindikale etj. BSPK-ja pranon dhe respekton konventat ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për punë dhe të drejtat e obligimet që rrjedhin prej tyre, veçanërisht Deklaratën universale të të drejtave të njeriut. BSPK-ja është e vetmja organizatë sindikale në Kosovë. (Osman Ismaili).

BASHOLLI Arlind (1991-). Gazetar i sportit. Lindi në Vushtrri. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ndërsa studimet për informatikë në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2009 filloi të punojë si gazetar i sportit në gazetën "Tribuna shqiptare", ku qëndroi deri në vitin 2014. Është gazetar i sportit në portalin "Gazeta express". Krahas gazetarisë, punon si inxhinierit ultrasonik si dhe inxhinier aplikacioni. (Florim Maliqaj)

BASHOTA Nuri (1933-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Gjakovë dhe Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin Ekonomik të



NURI BASHOTA

Universitetit të Beogradit. Në vitin 1963 përfundoi studimet e magistraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, drejtimi ekonomik, ndërsa në vitin 1964 mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik të

Universitetit të Parisit në Sorbonë. Në vitin 1974 doktoroi në katedrën e shkencave

ekonomike në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Është njëri ndër themeluesit e Fakultetit Ekonomik e Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi pa ndërprerje nga viti 1961 e deri në vitin 2002, kur doli në pension. Ligjëroi lëndën e ekonomisë politike dhe zhvillimin e mendimit ekonomik në Fakultetin Ekonomik, në Fakultetin Juridik, në Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Prishtinës. Mbahti ligjërata edhe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin Ekonomik të Bratisllavës etj. Gjatë veprimtarisë shumëvjeçare publikoi shumë punime shkencore dhe profesionale, tekste shkollore dhe mori pjesë aktivisht me punime e kumtesa në shumë tubime, këshillime dhe konferenca shkencore të ekonomistëve në Kosovë dhe në botën e jashtme. Ishte dekan i Fakultetit Ekonomik dhe drejtor i Entit për Hulumtime Shoqërore-ekonomike në Fakultetin Juridik-Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. (Myrvete Badivuku- Pantina)

BASHOTA Sali (1959). Poet, studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Caravik të Klinës. Kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin në Kijevë, u diplomua për letërsi shqipe në



SALI BASHOTA

nga romantizmi shqiptar. Në vitet 1999-2003 ishte kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re” dhe themelues e drejtor i Shtëpisë Botuese “Rozafa”. Ishte drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në periudhën 2003-2013. Është autor i librave me poezi, prozë poetike, studimeve për letërsinë. Për veprën e tij Bashota është nderuar me disa çmime të rëndësishme. Gjithashtu është njëri ndër poetët më të përkthyer të Kosovës në gjuhë të ndryshme dhe pjesë e shumë antologjive. Nga veprat e tij në poezi veçojmë: “Albumi i grisur” (1986), “Zogu me profil vjeshte” (1989), “Dalje nga trishtimi” (1999), “Ndiz dritën magjike”

(2002), “Dorëshkrimi i ngjallur” (2011), “Dhembje e bekuar” (2013) etj. Ndërsa vepra në prozë poetike janë “Ëndrra në parajsë” (2006), “Sytë e vetmisë” (2010), “Rrozullimi i zjarrit” (2011) etj. Verbin poetik të Bashotës e shquan dhembja për njeriun, pësimi, trishtimi dhe dashuria e munguar, të artikuluar nëpërmjet mbizotërimit të figurës së ironisë e paradoksit. S. Bashota shquhet për studimet në letërsinë dhe publicistikën shqipe sidomos me veprat “Shqipshkrimi kritik” (1997) dhe “Proza e fill-eve të modernitetit” (2006). (Nysret Krasniqi)

BASHOTA Sokol (1966-). Veprimtar, njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Caravik të komunës së Klinës. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Që herët u përfshi në aktivitetet e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Në kuadër të LPK-së ishte udhëheqës i grupit luftarak për Klinë. Për shkak të veprimtarisë



SOKOL BASHOTA

politike u burgos disa herë (më 1984, 1986 dhe 1993). Ishte njëri nga bashkëthemeluesit e UÇK-së dhe organizator i sulmeve të sinkronizuara ndaj njëmbëdhjetë stacioneve policore serbe në vitin 1997. Gjatë luftës mbajti pozitën e zëvendëskomandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që nga themelimi dhe ishte anëtar i Drejtorisë Politike (pas strukturimit të UÇK-së), më pas zëvendëskomandant për operacione luftarake në betejat te gryka e Llapushnikut, te Dollci, te Likovci, në Zonën Operative të Pashtrikut, në Zonën Operative të Nerodimes dhe në Zonën Operative të Dukagjinit. Pas përfundimit të luftës ishte deputet i Parlamentit të Kosovës (2004-2007) dhe kryetar i komunës së Klinës që nga viti 2008. (Skënder Lutfiu)

BASHTINA. Njësi administrativo-pronësore në shoqërinë feudale mesjetare të Europës, e pranishme edhe në treva shqiptar në periudhën bizantine dhe osmane. Nënkuptonte pronën, në rend të parë të patundshme, të trashëguar nga paraardhësit, por ndonjëherë dhe nga shteti dhe organizimi kishtar. Parimisht trashëgohej në vijën mashkullore. Në mes të pronarëve nuk

parashiheshin dallimet etnike apo fetare. Me bashtina zotëronin dhe të huajt. Dokumentet e shek. XIV-XV dëshmojnë se në Kosovë ky fenomen ishte i pranishëm dhe se kishte përfshirë edhe raguzanët, kotorrasit, sasët etj., të cilët vepronin dhe jetonin në Novobërdë, Trepçë, Janjevë etj. Perandoria Osmane e gjeti në Ballkan këtë institucion administrativo-pronësor dhe ia përshtati sistemit të vet administrativ. Në vendet e pushtuara të Rumelisë (Ballkanit), osmanlinjtë lejuan që të krishterët t'i trashëgonin vreshtat, kopshtet dhe shtëpitë, si kompensim për shërbimin e tyre në ushtri dhe në oborin e sulltanit, por toka konsiderohej si "mall i shtetit" (*devlet mali*). DeFTERËT osmanë të shekullit XVI dëshmojnë se në Kosovë bashtina kishin edhe disa myslimanë, përkatësisht të krishterë, të cilët edhe pasi kishin pranuar islamizimin vazhdonin t'i mbanin bashtinat e tyre familjare. Raste të tilla kishte në Prizren, Gjakovë, Trepçë, Vuçitërnë, Prishtinë etj. (Gazmend Rizaj)

BATALIONI "ATLANTIKU" (1999). Formacion ushtarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i formuar nga vullnetarë shqiptarë të SHBA-së. U themelua në Nju-Jork në mars të



LUFTËTARË TË BATALIONIT "ATLANTIKU"

vitit 1999 nga aktivistë të Fondit "Vendlindja thërret". Formacioni përbëhej nga vullnetarë shqiptaro-amerikanë me prejardhje nga të gjitha hapësirat shqiptare. Të parapërgatitur nga ushtarakët shqiptarë Skënder Doçi (admiral)

dhe Asllan Bushati (kolonel), më 11 prill 1999 në Yonkers (parku i Hotelit "Royal Regency") të Nju-Jorkut dhanë betimin dhe bënë parakalimin mbi 400 djem dhe vajza me uniformën e UÇK-së. Në ceremoni morën pjesë mijëra qytetarë, veprimtarë dhe familjarë të ushtarëve të këtij Batalioni. Mediet amerikane i kushtuan hapësirë të madhe këtij parakalimi para nisjes për luftë në Kosovë. Më 13 prill 1999, pasi nga Ambasada e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara u sigurua dokumentacioni, ushtarët e batalionit "Atlantiku" arritën në Tiranë. Fillimisht batalioni u vendos në Golem të Durrësit, ku nga eprorët e ushtrisë shqiptare u bënë përgatitjet teorike dhe fizike. Më pas ushtarët u vendosën në qendrën e mobilizimit dhe trajnimeve të UÇK-së në Burrel, ku kishte mbi 3,600 ushtarë të tjerë. Këtu sërish u kryen stërvitjet intensive nga oficerë të njësive elite të Akademisë së Mbrojtjes të Shqipërisë. Batalioni "Atlantiku" më pas mori pjesë në shumë beteja dhe në Operacionin "Shigjeta" në Pashtrik dhe Koshare, i udhëhequr nga shefi i Shtabit të Operacionit Gani Shehu, komandanti i batalionit "Uran Rexhepi" dhe zëvendëskomandanti Fadil Idrizi. Në kuadër të këtij batalioni luftuan edhe vullnetarë të huaj, si anglezë, izraelitë, kanadezë, gjermanë, francezë etj. (Ali Uka)

BATALI Fadil (1943-2004). Mjek mjekoligjor, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Mbaroi shkollën fillore dhe gjimnazin në Gjakovë, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Novi-



FADIL BATALLI

Sad. Kreu specializimin nga mjekësia ligjore në Prishtinë dhe në Novi-Sad. Në vitin 1972 u zgjodh ligjërues i mjekësisë ligjore në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1976 mbrojti disertacionin e doktoratës dhe një vit më vonë u zgjodh docent dhe më pas profesor inordinar dhe ordinar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë për lëndën mjekësia ligjore (1987). Në të njëjtën kohë lëndën e mjekësisë ligjore e ligjëronte edhe në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Ishte doktori i parë i shkencave të mjekësisë ligjore në Kosovë. Në periudhën 1980-1984 kreu detyrën e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Është autor i monografisë "Probleme

deontologjike te shkeljet mjekësore”, si dhe i tekstit universitar për studentët e mjekësisë dhe drejtësisë “Mjekësia ligjore”. Publikoi dhe një varg punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë shtetit.. (Flamur Blakaj)

BATALI Qamil (1936-2009). Shkrimtar, gazetar, autor tekstesh shkollore. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për pedagogji i mbaroi në



QAMIL BATALLI

Beograd. Në fillim punoi si mësues në komunën e Kaçanikut, ndërsa më 1959 kaloi në Radio-Prishtinë, në redaksinë e emisioneve për fëmijë. Punoi si kryeredaktor i gazetës arsimore “Shkëndija” dhe një kohë të gjatë ishte edhe kryeredaktor i revistës “Pionieri”. Q. Batalli njihet kryesisht si shkrimtar për fëmijë dhe zë një vend me rëndësi në mesin e shkrimtarëve të brezit të dytë. Botoi dy përmbledhje me poezi për fëmijë (“Nisuni pëllumbat e mi”, “Duararta”) dhe një sërë librash me tregime, romane dhe drama, si për fëmijë, ashtu edhe për të rritur. Me sukses e kultivoi prozën për fëmijë, që shihet nga përmbledhjet e botuara me tregime për fëmijë, si dhe nga romanet “Princesha e bariu” (1971) dhe “Agimet e kaltra” (1973). Shkroi edhe tekste shkollore, ndër të cilat edhe Abetaren, me të cilën u rritën breza të shumtë shkollarësh në Kosovë. Romanet e tij për fëmijë, shikuar nga aspekti tematik dhe i ndërtimit, mbështetën mbi shtratin e përrallës ose trajtojnë aspekte të jetës bashkëkohore. Në të dy rastet kryetëm kanë raportin prindër-fëmijë. Veprat e tjera të botuara: “Buzëqeshjet” (1966), “Dëshira” (1967), “Njomëzat” (1967), “Tri dritare” (1971), “Dyzet tregime”, (1972), “Dikush troket në derë” (1973), “Mësuesja Dallëndyshe” (1980), “Ndodhitë e Xhanxhafilit” (1984), “Ejona” (1987), “Shoku im Learti”, (2008) etj. (Xhevat Sylja)

BATJARI Ilmi (1965-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Blaç të komunës së Dragashit. Mori pjesë në demonstratat e vitit 1981. Si i mitur, u dënua me 20 ditë burg dhe u përjashtua nga shkolla. Gjatë viteve 1989-1990 mori pjesë në aktivitete politike të kohës dhe u dënua tri herë me nga 60 ditë burg. Më pas emigroi në Austri dhe Zvicër.

Në vitin 1998 ishte ndër të parët që iu përgjigj thirrjes për luftë të armatosur. Për afro gjashtë muaj ishte në Glllogjan, në radhët e UÇK-së, si luftëtar i njësitit “Shqiponjat e zeza”. Më 10 maj 1999, bashkë me luftëtarët e tjerë, u nis për në Koshare, ku më pas, më 15 maj, u vra në luftimet e zhvilluara në këtë zonë. (Besim Myrtezani)

BATLLAVA. Fshat në komunën e Podujevës, rreth 9 km në jug të qendrës komunale. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,757 ha. Përmendet në disa dokumente të shkruara mesjetare, si në defterin kadastral osman të vitit 1487, ndërsa me emrin Batllava përmendet në hartën ushtarake austriake të vitit 1689. Ndërtimi i pendës (1962) përfshiu edhe një pjesë të ngastrës së fshatit. Për këtë arsye u bë zhvendosja e disa familjeve në Podujevë dhe në vendbanimet përreth. Në vitin 1981 kishte 205 shtëpi me 1,895 banorë. Poullsisa merret kryesisht me blegtori, pylltari, veprimtari shërbese-hoteliere etj. (Skënder Halimi)

BATO. Mbret i Dardanisë. Ishte djalë i mbretit Longar, fronin e të cilit e trashëgoi. Në vitin 200 p.e.r. i priu delegacionit të mbretit Longar për ta lidhur aleancën antimaqedone me romakët në kampin ushtarak të konsullit Galba. Në vitin 199 p.e.r. hyri me ushtri në krahinat veriore të Maqedonisë, përmes Pellagonisë, duke shfrytëzuar angazhimet e Filipit V në luftë me romakët, në pjesën perëndimore të Maqedonisë. Ishte kjo arsye pse Filipi V e ngarkoi gjeneralin e tij Atenagorën ta udhëhiqte ushtrinë maqedone në luftë kundër dardanëve. Për përmasat dhe pasojat e betejës nërmjet tyre flet Tit Livi në veprën “Historia”. (Emine Kalaja-Hajdari)

BATUSHA Islam Agë (-1878). Veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në fshatin Batushë, komuna e Gjakovës. Ishte luftëtar i degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë. Në luftimet në Gjakovë kundër Mehmet Ali Pashës dhe Avdullah Pashë Drenit, në shtator të vitit 1878, I. Batusha iu priu vullnetarëve të anës së tij, duke dhënë kontribut në fitoren që arritën forcat e Lidhjes në këto luftime. Nga ana e luftëtarëve të lidhjes me këtë rast u vranë rreth 400 veta, midis tyre edhe Islam Agë Batusha. (Luan Tetaj)

BATUSHA Sulejman Agë (-1915). Njëri ndër krerët më të njohur në Lëvizjen Kombëtare

Shqiptare në rrethinën e Gjakovës. Lindi në fshatin Batushë të Gjakovës. Pas Ali Ibrës, e përfaqësonte fisin e madh të Gashit. Në shumë ngjarje të rëndësishme e udhëhoqi fisin e tij në luftë kundër Perandorisë Osmane. Në gusht të vitit 1904 vatër e kryengritjes u bë Gjakova, ku u grumbulluan 5,000-6,000 kryengritës, të cilëve iu printe S. Batusha. Më 14-23 korrik të vitit 1908 në Kuvendin e Ferizajt përfaqësoi rajonin e Gjakovës. Ishte pjesëmarrës edhe në Kuvendin e Verrave të Llukës, në mars-prill të vitit 1910. Mori pjesë edhe në takimin e krerëve të Malësisë së Madhe dhe të Gjakovës, të mbajtur në Cetinë. Në atë takim krerët u pajtuan që kryengritja të fillonte në prill. Në krye të kryengritjes, së bashku me Isa Boletinin, ishte edhe S. Batusha. (Luan Tetaj)

BAUTA Petrit (1935-). Gjyqtar i futbollit. Lindi në Strugë. Pas kryerjes së normales, punoi si mësimdhënës në fshatin Matejçë të Kumanovës, pastaj në Koroshishtë të Strugës dhe në shkollën fillore të qytetit të Strugës. Gjatë viteve '60 luajti futboll për skuadrën e "Karaormanit", ku u bë idhull i tifozëve të kësaj skuadre. Në vitet '70 si gjyqtar ndërkombëtar i futbollit (FIFA) ndau drejtësinë në ligat elite të ish-Federatës së Jugosllavisë. (Besim Kajtazi)

BAXHAKU Bashkim (1953-). Inxhinier, profesor universiteti. Lindi në Bellobrad të Dragashit. Shkollën fillore e kreu në Dragash, të mesmen në Prizren. Kreu studimet



BASHKIM BAXHAKU

në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1977). Studimet e magistraturës i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Beogradit, ndërsa tezën e doktoraturës e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të UP-së (1997). Në Fakultetin Teknik të UP-së më 1977 u zgjodh asistent, kurse titullin profesor i rregullt e mori më 2012. Mbajti ligjërata nga disa lëndë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së: modelimi dhe simulimi në komunikacion, konstruksioni i motorëve, modeli i proceseve të motorët etj. Mbajti ligjërata edhe në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Veterinës të UP-së në lëndët informatikë, përdorimi i kompjuterit në bujqësi etj. Është autor dhe

bashkautor i një sërë punimesh profesionale e shkencore të publikuara në revista dhe përmbledhje studimesh. Është autor i disa teksteve dhe i dispensave universitare ("Vizatim teknik me gjeometri deskriptive", "Bazat e makinerisë", "Motorët me djegie të brendshme" etj.). (Fehmi Krasniqi)

BAZA TARIFORE. Paraqet vlerën e tërësishme të një të mire ose shërbimit mbi të cilën bëhet përlllogaritja e obligimeve tatimore nga autoritetet taksuese në një vend. Në rastin e Kosovës kjo përlllogaritje bëhet nga Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Baza tarifore është e rëndësishme edhe për faktin se shumica e të ardhurave tatimore mbli-dhen në kufi. Shpeshherë doganat caktojnë një çmim apo vlerë referuese për një mall a shërbim që i nënshtrohet doganimit dhe nuk marrin për bazë faturën e importit. (Lumir Abdixhiku)

BAZALTET. Shkëmbinj magmatikë vullkanikë me ngjyrë të errët, të përbërë nga plagjiokllazi bazik dhe piroksenët, të pakristalizuara plotësisht, me natyrë mikrolitike, shpeshherë me teksturë poroze e bajamore. Në përbërje paraqitet edhe xhami vullkanik, olivina e ndonjëherë nefelina, leuciti etj. Bazaltet janë ekuivalentë efuzivë i gabrove. Dallohen bazaltet toleitike dhe alkaline. Së bashku me andezitet, me të cilët shpesh bashkëshoqërohen, bazaltet përbëjnë pjesën kryesore të lavave kontinentale dhe oqeanike. Lavat bazaltike janë tepër fluide dhe formojnë derdhje lavike që kanë trajta (çashmëri) shtyllore, prizmatike, masive, të litarëve të përdredhur etj. Në Kosovë bazaltet kanë përhapje të kufizuar, kryesisht janë të moshës jurasike. Paraqiten në veri të Mitrovicës, të shoqëruar me andezite (Leposaviq), në veri të Gjilanit, në juglindje të Kaçanikut, në jug të Gjakovës dhe në veriperëndim të Rahovecit. (Naser Peci)

BAZILIKA E ULPIANËS. Bazilikë një-ani-jatëshe longitudinale e krishterimit të hershëm. Ka absidë impozante gjysmërrethi në lindje dhe atrium dhe narteks në perëndim (38.10 x 20.50 m). Ndodhet në pjesën veriore të Ulpianës, pranë rrugës kryesore (cardo maximus) dhe është ndër bazilikat më të mëdha dhe më luksoze të Dardanisë. Është ngritur me gurë të latuar mesatarë, të lidhur me llaç gëlqereje (opus incertum, trashësia 0.60-1.10 m). Në mesin e absidës ruhet teknika e ndërtimit me

gurë dhe 2-3 rreshta me tulla (opus mixtum). Në veri të atriumit gjendet hyrja e vogël. Ngjitur për atrium është narteksi, ku si prag është vendosur stela e periudhës së mëhershme romake. Në të dy anët e narteksit janë dy anekse të vogla drejtkëndore, diakroniku në jug e proskomidia në veri, kurse nën proskomidi gjendet një kriptë. Në lindje të diakronikut është dhe një absidë e vogël. Tri hyrje (tribelon) në murin lindor të narteksit shpijnë në anijatë, ngjashëm me hyrjet e kishave paleokristiane me tri anijata. Muret e jashtme të anijatës janë përforcuar me nga tri pilastra. Dyshemeja e narteksit është shtruar me tulla, ndërsa anijata kishte dy nivele me dysheme, njëra me tulla e llaç gëlqeror të njëjtës kohë me bazilikën dhe tjetra me mozaik monokrom, që i takonte një objekti më të hershëm. Në dyshemenë e absidës ishte varri monumental i një shenjtori, i vendosur mbi një varr të vogël. I takon shek. V-VI. (Haxhi Mehmetaj)

BAZILIKAT (shek. IV-VI e XIV). Paraqet një tip të ndërtimit kishtar, ndërtim konservativ, që ka planimetri me bazë kënddrejtë dhe të mbuluar me çati druri. Këtë mënyrë të ndërtimit e ndeshim jo vetëm ndërmjet periudhave të Augustit e Justinianit, por edhe më vonë në Perëndim, pothuajse në të gjitha vendet ku ishte përhapur krishterimi. Planimetria më e thjeshtë është bazilika me tri anijata. Anijata kryesore mbaron më absidën gjysmërrethore apo në formë tri ose pesëfaqëshe. Bazilikën si ndërtim e hasim edhe para artit të vjetër të krishterë, që në paganizëm. Para se të shndërroheshin në objekte kulti, godinat kishin karakterin e një objekti publik dhe përdorej si sallë gjyqi. Bazilika si tip arkitektural parapëlqehet nga mbretërit e kohës. Shndërrimin në objekt kulti të krishterë në rend të parë ia mundësoi altari, i cili zinte vend në skemën kompozicionale të godinës. Anijata qendrore kishte lartësi më të madhe, për dallim nga dy anijatat anësore. Anijata qendrore ndriçohej nga dritaret, që hapeshin mbi çatitë e anijatave anësore. Edhe në Dardaninë antike dhe në mesjetën e hershëm u ndërtuan bazilika. Si rrënoja ato i hasim në shumë lokalitete arkeologjike, si në Ulpianë, në Municipin DD, në Soçanicë, në Siperanti, në Pejë, në Harilaq të Fushë Kosovës, në Hajnoc të Kamenicës, në Vrellë të Istogut, në Shën Arkangjel, në Prizren etj. Disa nga këto kisha u adaptuan dhe u rindërtuan gjatë periudhës

Nemanjide, në shek XIV. Të tilla janë kishat në Patrikanën e Pejës, Shën Prenë në Prizren, Kisha e Manastirit të Graçanicës, në Banja në Mitrovicë, kisha në Manastirin e Deçanit etj. Bazilikat perëndimore u ndërtuan në Kosovës edhe gjatë shek. XIX dhe XX, përfshirë edhe Katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë, që u ndërtua së fundi. (Fejaz Drançolli)

BEBA Kadri (1876-1948). Luftëtar antikomunist, i dënuar politik. Lindi në fshatin Ribar i Madh të Lipjanit. Gjatë Luftës së Parë Botërore luftoi pushtuesit bullgarë dhe më pas iu bashkua çetave që luftonin pushtuesin serb. Më 1938 u arrestua nga xhandarmëria serbe dhe u internua në kampin e Uzhiçka Pozhegës në Serbi. Më 1941, me përfshirjen e Kosovës në kuadër të Shqipërisë, emërohet kryetar i komunës së Lipjanit. Mori pjesë në betejën e Prapashticës (tetor 1944), afër vijës kufitare me Serbinë. Si pjesëtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare mori pjesë në Kongresin e Lipovicës. Në dimrin e vitit 1944/45 kalon në ilegalitet me gjithë familjen. Në prill të vitit 1947, meqë OZN-a ia kishte arrestuar shumë anëtarë të familjes, u dorëzua. Dënohet me 13 vjet burg nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Në prill të vitit 1948 pushkatohet në Tauk Bahçe të Prishtinës. Varri nuk i dihet. (Skënder Lutfiu).

BEBIQ Dushan (Dušan Bebić) (1922-1978). Pemëtar. Lindi në Stara Gradishkë, në Kroaci. Fakultetin e Bujqësisë për pemëtarë dhe vresh-tari dhe doktoratën i kreu në Universitetin e Beogradit (1964). Punoi në Institutin Bujqësor të Kosovës dhe ishte udhëheqës i Entit për Pemëtarë në Pejë. Ka bërë inventarizimin e llojeve të pemëve që kultivohen në Kosovë dhe studioi edhe kultivarët autoktonë të mollëve e të dardhëve në Rrafshin e Dukagjinit. Në mënyrë të hollësishme përshkroi të gjithë kultivarët e mollëve dhe të dardhëve autoktone, sipas përhapjes, ku kanë mbizotëruar mollët Vizajka (30%) dhe Gjylja (25%). Ai mbrojti pikëpamjen se Rrafshi i Dukagjinit ka kushte agropedologjike dhe ekologjike të mira për prodhimtari të suksesshme në pemëtarë dhe se në pemishtet e kësaj zone përdorej ujtitja që nga lashtësia. Në vitin 1960 zhvendoset në Fakultet të Bujqësisë të Universitetit të Beogradit. Publikoi disa libra dhe punime shkencore. (Agim Zajmi).

BECI. Fshat në komunën e Gjakovës, 7 km në verilindje të qytetit. Shtrihet në lartësi mbidetare 351-423 m. Përmendet si vendbanim në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 me emrin Beçi. Nga fshati Bec migroi një numër i konsiderueshëm i banorëve brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, popullsia shënoi rritje në dekadat e fundit. Në vitin 2011 kishte 1,223 banorë, ndaj 536 banorëve në vitin 1921. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 1,538 ha, nga e cila gjysma e sipërfaqes është me ara, 36% livadhe, 14% pyje. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Është qendër lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Zhdrellë, Sapot, Lug-Bunari dhe Qerim. Ka shkollë 9-vjeçare, qendër shëndetësore, disa njësi tregtare dhe disa objekte të kultit. (Qerim Kastrati)

BECI Bahri (1936-). Gjuhëtar, akademik. Lindi në Shkodër. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Tiranë (1958), ndërsa studimet pasuniversitare në Institutin e Fonetikës



dhe të Gjuhësisë së Zbatuar në Paris (1975-77). Më 1979 në Tiranë mori gradën shkencore “kandidat i shkencave”, ndërsa më 1977 në Paris kishte marrë gradën doktor i shkencave me tezën “Sistemi zanor dhe bashkëtingëllor i së folmes së qytetit të Shkodrës”. Sërisht në Tiranë më 1984 mbrojti tezën e doktoratës “Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës”. Qysh nga fillimet punoi në Institutin e Gjuhësisë dhe të letërsisë në Tiranë si bashkëpunëtor i vjetër shkencor, më vonë si profesor. Më 2008 u zgjodh anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga viti 1997 punoi si pedagog i shqipes në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe të Kulturave Orientale të Parisit (INALCO). Në vitet 1974-1975 ishte sekretar shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kryeredaktor i revistës “Studime filologjike” (1984-1993), sekretar i revistës “Studia albanica” (1993-1997) dhe drejtor i këtij instituti (1993-1997). Studimet e tij shtrihen në fushat e dialektologjisë, të fonetikës, të historisë së gjuhës dhe të gramatikës së shqipes. Në fushën e dialektologjisë është marrë me përshkrimin e shumë të folmeve të


BAHRI BECI

shqipes qendrore dhe të veriut (të Matit, të Dibërës, të Shkodrës), por njëherësh është marrë dhe me strukturën dialektore të gjuhës shqipe, me nyjëtimin e varieteteve dialektore dhe me historinë dialektore, me historinë e formimit të dialekteve të shqipes, duke i parë ato dhe në kontekstin ballkanik. Në kuadër të këtyre shqyrtimeve është marrë edhe me studimet fonetike, po edhe për çështje të shqipes standarde. Ndër veprat e tij veçohen “Të folmet veriperëndimore të gjuhës shqipe dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës” (1995), “Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri” (Pejë), “Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre” (2002), “Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike” (2002), “Fonetika e gjuhës shqipe” (1997), “Gegërishtja qendrore dhe grupimi i të folmeve të saj” (2007), “Historia e standardizimit të shqipes” (2010) dhe “Struktura dialektore e shqipes” (2016). Është bashkautor i “Atlasit dialektologjik të shqipes” I-II (Napoli 2007). B. Beci është hartues tekstesh shkollore për gramatikën e shqipes për të gjitha nivelet në sistemin shkollor në Kosovë dhe në Shqipëri. Nga viti 2016 është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Rexhep Ismajli)

BEÇIKEMI Marin (Marinus Becichemus Scodrensis) (rreth 1468-1526). Humanist, historian dhe profesor universiteti. Lindi në Shkodër, por të parët e tij ishin nga Beçiqi i sotëm (Mali Zi). Që në moshën 10-vjeçare, kur Shkodra ra nën sundimin osman (1479), M. Beçikemi u detyrua të shkonte në Ulqin. Nga këtu prindërit e dërguan për të mësuar në Breshia (Itali), qytet, që atëbotë ishte në kuadrin e Republikës së Venedikut. Pasi e kreu shkollimin në Breshia, në vitin 1492 Senati i Republikës së Raguzës e zgjodhi rektor të shkollave raguzane. Këtu bëri emër si pedagog, dijetar dhe mendimtar humanist. Në vitet 1501-1503 ligjëronte në Breshia, në katedrën e studimeve të gjuhëve klasike dhe të retorikës. Veprat e para të Beçikemit trajtonin çështje historike nëpërmjet “panegjirikeve”. Në këtë kuadër, në kontekst të historisë së Republikës së Venedikut, ka ofruar të dhëna jo të sakta për Betejën e Kosovës (1389), duke e quajtur Milosh Kopiliqin për perandor të Mezisë (*Mysiensium Imperatore Milosso Cobilichio*), ndërsa princ Lazarin e quan për despot të

Mezisë (*Lazaro Mysiae despoto*). Në vitin 1514 M. Beçikemi u ftua nga princesha Isabella d'Este, për të mbajtur ligjëratat në Mantova. Prej vitit 1517 e deri në vdekje (1526) ishte profesor i retorikës në Universitetin e Padovës. Në këtë qendër universitare botoi disa vepra filozofike dhe letrare dhe u ngrit në radhën e burrave më të ditur të kohës. (Jahja Drançolli)

BEGOLLI Faruk (1944-2007). Aktor, regjisor, profesor universiteti. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Studimet për aktrim i mbaroi në Akademinë



FARUK BEGOLLI

për Teatër, Film, Radio dhe TV në Beograd (1966). Luajti në mbi 60 filma e drama televizive, metrazhesh e zhanresh të ndryshme. Ishte një nga aktorët më të popullarizuar të filmit në ish-Jugosllavi. Në fillim të viteve '70 ishte një nga pedagogët e parë të aktrimit në degën e dramës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më vonë, më 1989, themeloi drejtimin e aktrimit dhe degën e artit dramatik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Aty, deri më 2007, ligjëroi lëndën e aktrimit. Për disa vjet (2000-2005) ishte drejtor i Teatrit "Dodona". Krijimtaria e tij artistike si aktor zë fill më 1966 me filmat jugosllavë "Shikimi në bebëzën e diellit" dhe "Ëndrra". Më pas luajti role kryesore dhe dytësore në shumë filma të produksionit vendor: "Mëngjesi", "Operacioni Beograd", "Atentati i Sarajevës", "Uka i Bjeshkëve të Nemuna", "Beteja e Neretvës", "Muri dhe trëndafili", "Rekuem", "E dashura Irenë", "Si të vdiset", "Valteri mbron Sarajevën", "Dervishi dhe vdekja", "Sulmi i kuq", "Majat e Zelengorës", "Roje e plazhit në periudhën e dimrit", "Skuadrilja partizane", "Kryengritja e Timokut", "Vuk Karaxhiq", "Nata në shtëpinë e nënës sime" etj. Që nga vitet '70 e tutje, zakonisht në role kryesore, luajti edhe në filmat e regjisorëve kosovarë, si: "Të ngjuarit" (1971), "Buka" (1973), "Mosmarrëveshja" (1978), "Epoka para gjyqit" (1978), "Era dhe Lisi" (1979), "Kur pranvera vonohet" (1980), "Përroi vërshues" (1981), "Proka" (1984), "Buka e hidhur" (1997), "Darka e drejt" (1997), "Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna" (1997), "Fotografia" (2003), "Metropolet" (2005) dhe "Etjet e

Kosovës" (2006). Rolet e tij në teatër ishin më të pakta. Në fillim, në vitet '60, luajti në Teatrin Jugosllav të Dramës dhe në Teatrin Popullor të Beogradit. Gjatë viteve '80 luajti në disa nga shfaqjet e Teatrit Popullor Krahinor, të tilla si: "Ah Xho", "Një varr për Boris Davidoviqin", "Dervishi dhe vdekja" dhe "Bregu i pikëllimit". Në Teatrin Kombëtar të Kosovës u rikthye më 2006 me kryerolin në dramën "Mbreti Lir" të Shekspirit. Në Teatrin "Dodona", kryesisht me studentët e tij, ka bërë gjithashtu regjinë e disa shfaqjeve teatrore, të tilla si: Profesor, jam talent se jo mahi", "Tregimi zoologjik", "Heronjtë e kombit", "Iluzionet e dashurisë", "Këngëtarja tullace", "Maturantët", "Martesa", "Stjuardesat", "Makiato boys", "Mbreti Ibish", "Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq" etj. U nderua me mirënjohje dhe çmime të ndryshme në ish-Jugosllavi, si dhe në vitet e pasluftës në Kosovë. (Bekim Lumi)

BEGOLLI Gazmend (1944-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Tiranë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, ndërsa studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Beogradit (1968). Fillimisht punësohet në kombinatin "Kosova" në Obiliq, ku ishte mbikëqyrës në montimin e blloqeve A3, A4, A5 dhe B1, inxhinier kryesor për kazanët e avullit, për turbinat dhe drejtor prodhimi në Termocentralin "Kosova A". Kontribuoi që gjuha shqipe të përdoret në sistemet komanduese të termocentralit. Në periudhën 1984-2000 zhvilloi aktivitete biznesi privat në Libi dhe Shqipëri. Pas kthimit në Kosovë (2000) u angazhua në Korporatën Energjetike të Kosovës, ku ishte menaxher në disa sektorë, në termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B". Në vitet 2005-2008 ishte këshilltar në Ministrinë për Energji dhe Miniera. Në periudhën 1969-1984 ishte i angazhuar edhe në procesin mësimor në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës. (Shyqeri Kelmendi)

BEGOLLI Ismet (1955-). Gazetar, i burgosur politik. Lindi në fshatin Kaçanuell të Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në Bajçinë, gjimnazin në Podujevë, Fakultetin Juridik, degën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në Universitetin e Prishtinës. Punoi gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës. Kryesisht u mor me shkrim nga lëmi i zhvillimit social dhe ekonomik të Kosovës. Në fillim të viteve '80 u përfshi në lëvizjen ilegale për çlirimin e Kosovës, më 1984

u burgos dhe vuajti dënimin me burg deri në korrik të vitit 1991. (Shefqet Rexhepi)

BEGOLLI Istref (1933-2000). Aktor. Lindi në Pejë. Me aktrim filloi të merrej që nga viti 1949, kur u bë pjesë e trupës së Teatrit Popullor Krahinor. Në periudhën 1961-1971 ishte i angazhuar



ISTREF BEGOLLI

si aktor në trupën rezidente të Teatrit Jugosllav të Dramës në Beograd, ku realizoi një numër rolesh. Por si aktor u realizua në Teatrin Krahinor të Prishtinës. Me mbi gjysmë shekulli karrierë në skenë, I. Begolli konsiderohet ndër aktorët më të shquar të skenës shqiptare. Me një pamje imponante, me timbër dhe shprehje ekspresive ishte protagonist i shfaqjeve që shënuan sukseset më të mëdha në historinë e teatrit në Kosovë. Për rolet e realizuara u nderua me shumë çmime. Për rolin e Priftit në shfaqjen “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” në regji të P. Manit u shpall aktori më i mirë në takimet “Joaqim Vujiq” (1973), ndërsa për rolin e Kabilit në “Sfinga e gjallë” në regji të L. Georgijevskit mori çmimin “Maska e artë” në Festivalin e Skenave Eksperimentale, në Sarajevë (1978). Pastaj mori edhe çmimin për rol episodik në Festivalin “Sterijino Pozorje” të Novi-Sadit (1985), për rolin në shfaqjen “Konfiteori” në regji të Vladimil Milçinit. Në skenën jugosllave I. Begolli u bë i njohur edhe me rrolin kryesor në “Makbethin” në regji të G. Paros (1975) i, cili u vlerësua lart nga kritika në “Lojrat Verore të Dubrovnikut” (1978). Gjithashtu u vlerësua për kreacion të suksesshëm artistik në Festivalin e Steries në Novi-Sad (1985 dhe 1987) për rolet e tij në shfaqjet “Dervishi dhe vdekja” dhe “Bregu i pikëllimit”, që të dyja në regji të V. Milçinit. Nga rolet e shumta që realizoi, mund të veçohen edhe Murtaja në “Shtetrrethimi” në regji të T. Durbeshiqit (1974), Agamemnoni në “Ifngjenia ne Aulidë” në regji të F. Hysajt (1983) dhe Sokol Shpendi në “Shpend Sokoli i Sokol Shpendit” në regji të Isa Qosjes (1989) etj. Pos në teatër, I. Begolli krijoi një profil të veçantë aktrimi edhe në fushën e filmit. Realizoi mbi 20 role në filmat: “Atentatorët e Selanikut” të Zh. Mitroviqit, “Era dhe Lisi” të B. Sahatçiu, “Proka” të Isa Qosjes, “Përroi vërshues” të B. Sahatçiu, “Si të vdiset” të M. Stamenkoviqit, “Sulmi i kuq”

të P. Golluboviqit, “Të ngjuarit” i E. Kryeziut, “Kulla” të Agim Sopit, “Dhembja krenare” të Ismail Ymerit, “Vallja e çmendur” të Isa Qosjes, “Vjeshta e trëndafilave” të A. Sopit etj. Për punën e tij në teatër dhe film u nderua me shumë çmime dhe mirënjohje. (Fadil Hysaj)

BEGOLLI Mahmud Hydaverdi Pashë (1670-1705). Pushtetar dhe ushtarak osman. Lindi në Pejë. Në vitin 1694 ishte mytesarif i Qystendilit. Pas vrasjes së të vëllait të madh, Mahmud Pashës në betejën e Lugoshit (1695), Hydaverdi Pasha erdhi në pozitën e sanxhakbeut të Prizrenit dhe të Dukagjinit dhe në këtë cilësi mori pjesë në betejën e Sentës (në Baçkë, te lumi Tisa) në vitin 1697. Në vitin 1700 u caktua në pozitën e sanxhakbeut të Shkodrës, të cilit i nënshtroheshin edhe sanxhakbeu i Ohrit dhe ai i Vlorës. Mbante lidhje miqësore dhe korrespondencë me Vinçenc Zmajeviqin, argjipeshkëv i Tivarit dhe vizitor apostolik në Shqipëri. Takime pati edhe me shoqëruesin e Zmajeviqit, kavalierin Gjon Bollica nga Kotorri, me të cilin ishte në lidhje familjare. Tregoi qëndrim miqësor edhe ndaj organizatorëve të Kuvendit të Arbrit, që u mbajt në Lezhë (1703). Vdiq në Shkodër i helmuar, duke qenë guvernator i Shkodrës. I biri i tij, Ahmed Pashë Sarhoshi në vitin 1706 ishte sanxhakbeu i Prizrenit, ndërsa në vitin 1721 qe sanxhakbeu i Dukagjinit. Po ashtu edhe nipi i tij, Hydaverdi Pasha II, i biri i Ahmed Pashës, pas vdekjes së t’ et në vitin 1735, erdh në pozitën e sanxhakbeut të Dukagjinit, ndërsa në vitin 1738 u bë sanxhakbeu i Shkodrës. Edhe Ahmed Pasha II, i biri Hydaverdi Pashës II, në vitin 1762 qe sanxhakbeu i Elbasanit, ndërsa në vitin 1770 sanxhakbeu i Dukagjinit. (Nehat Krasniqi)

BEGOLLI Menduh (1927-2000). Gjuhëtar. Lindi në Pejë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën Normale në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Beograd (1952). Ishte mësimdhënës i gjuhës shqipe në gjimnazin e Pejës. Më pas u emërua këshilltar pedagogjik krahinor në Prishtinë. Më 1967 u zgjodh profesor i Shkollës së Naltë Pedagogjike të Prishtinës, ndërsa më 1974 ligjërues i metodikës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Këtu ka punuar deri në pension, më 1990. Ka botuar disa tekste shkollore. (Agnesa Hasimja)

BEGOLLI Nexhat (1923-2005). Mësimdhënës veteran. Lindi në Pejë, ku kreu edhe shkollën fillore. Gjymnazin e kreu në Tiranë. Studimet i filloi në Akademinë Ushtarake dhe në Fakultetin e Mjekësisë në Itali, por nuk i përfundoi. Studioi në degën e romanistikës në Fakultetin Filozofik në Beograd. Në vitin 1945 filloi punën si mësimdhënës dhe drejtor gjymnazi në Pejë, pastaj në Prishtinë. Me ndërprerje kreu funksione të ndryshme, punoi në NGBG “Rilindja” në Prishtinë, në rektoratin e Universitetit të Prishtinës, në Entin për Përparimin e Arsimit e të Edukimit në Prishtinë, të cilin e drejtoi vite me radhë. Në vitin 1974 filloi punën e ligjëruesit të gjuhës dhe të letërsisë italiane në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. U mor edhe me përkthime nga italishtja në shqip dhe me publikime nga fusha e arsimit. (Afërdita Deva-Zuna)

BEGOLLI Nexhmije (1923-2003). Mësuese veterane. Lindi në Pejë, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në Institutin femëror “Nana e Skënderbeut”, dega e Normales në Tiranë. Punën si mësuese e filloi në vitin 1942 në Shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë, pastaj ishte instruktore e arsimit, përkatësisht mësuese në Shkollën fillore “Vuk Kraxhiq” në Prishtinë, pastaj sërish në Pejë dhe karrierën e mësuesisë e përfundoi më 1978 në Shkollën fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë. U shqua për përkushtim në punë dhe për profesionalizëm. (Afërdita Deva-Zuna)

BEGOLLI Sefedin (1980-1946). Deputet i Parlamentit të Mbretërisë Jugosllave, kryetar i Prefekturës së Pejës në periudhën 1941-1944. Lindi në Pejë. Vinte nga familja Mahmutbegollëve, me ofiqe, me pasuri dhe prona të shumta në kohën e Perandorisë Osmane. Shkollimin e filloi në Medresenë e Shkupit, vazhdoi në Stamboll shkollën e Lartë të Drejtësisë, dhe në Vjenë të Austrisë, ku ishte internuar më parë për disa vjet. Më 1919 mori pjesë në zgjedhjet e para pas Luftës së Parë Botërore, në radhët e Partisë Demokrate Serbe, ku u zgjodh deputet i Parlamentit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Në vitin 1932 emërohet senator i mbretit ndërsa në vitin 1937 u kandidua në zgjedhjet për Bashkësinë Islame të Vakëfit të banovinës së Zetës dhe Vardarit. Nga prilli 1941 deri më


17 nëntor 1944 ishte kryetar i Prefekturës së Pejës, e cila aso kohe në përbjeje kishte nën-prefekturën e Istogut, Skënderajt, Rozhajës, Tutinit dhe Plavës. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, për t’i shpëtuar hakmarrjes komuniste, kaloi në ilegalitet. Më 1946 u rrethua nga OZN-a dhe për të mos rënë në duart e saj, vetëvritet duke e helmuar veten. Organet e pushtetit komunist trupin e tij e ekspozuar në qendër të qytetit të Pejës, te Sheshi i Zallit. U varros fshehurazi në një lokacion të panjohur. (Daut Bislimi)

BEGOLLI Xhevat (1890-1945). Luftëtar antikomunist, bashkëpunëtor i Komitetit të Kosovës, prefekt i Pejës (1941-1944). Shkollën fillore e kreu në Pejë, ndërsa të mesmen në Vjenë. Punoi në gjymnazin e Pejës. Në prill të vitit 1941, bashkë me Xhafer Devën, Aqif Blytën dhe të tjerë nënshkroi marrëveshjen e Mitrovicës me gjeneralin gjerman Eberhad. Ishte pjesëmarrës në themelimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, si përfaqësues i prefekturës së Pejës. Kishte rol udhëheqës në organizimin e mbrojtjes së Pejës kundër forcave çetnike serbo-malazeze të Gjurishiqit. Në vitin 1944, pas një beteje në Lipë, zihet rob nga forcat e OZN-ës dhe e burgosin në shtëpinë e tij, e cila ishte shndërruar në burg famëkeq. Nga pushteti komunist u dënua me pushkatim, por vdiq nga torturat para se të ekzekutohej. (Daut Bislimi)

BEGOLLI Zenel (1863-1915). Luftëtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në Pejë. Në vitin 1899 u përfshi në organizimin e Lidhjes së Pejës. Ndihej nga afër Haxhi Zekën në përgatitjen e Kuvendit të Pejës (24-28 janar 1899). Në vitet më pas bashkëpunoi me Isa Boletinin e Idriz Seferin për organizimin e rezistencës antiosmane në Kosovë. Në shkurt të vitit 1903, me Zejnullah beg Vuçitërnin dhe Aqif Pazarin organizoi një lëvizje të gjerë kundërosmane në Kosovë. Në vitin 1909 u takua në Pejë me Isa Boletinin, për organizimin e kryengritjes dhe në maj të vitit 1910 mori pjesë në kuvendin të Verrat e Llukës, si përfaqësues i parisë së Pejës. Në nëntor të vitit 1912 u zgjodh delegat i Pejës në Kuvendin Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë. Në qershor 1914 u vendos me kërret e Kosovës në Durrës, ku u takua me Princ Vidin. Po këtë vit u kthye në Kosovën e pushtuar nga forcat

serbo-malazeze. U largua me gjithë familjen dhe u vendos në Stamboll. Pas një kohe u ftua në një gosti nga disa autoritete turke dhe, me t'u kthyer në shtëpi, vdes i helmuar. (Kosovar Basha)

BEGRACA Mehmet (1934-2010). Mjek, specialist i mjekësisë së punës, profesor universiteti. Lindi në Lushnjë, ku ishin vendosur prindërit e tij pas shpërnguljes nga Begraca



MEHMET BEGRACA

e Kaçanikut. Mbaroi shkollimin fillor në Ferizaj, kurse gjimnazin në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1961). Pas diplomimit punoi si mjek në Ferizaj. Prej vitit 1967 filloi punën në Dispanserin e Mjekësisë së Punës në

Kombinatin "Kosova" në Obiliq. Pasi përfundoi specializimin e mjekësisë së punës në Beograd, u zgjodh ligjërues i kësaj lënde në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mbrojti disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978), ku më vonë arrin të gjithë titujt universitarë. Ishte sekretar krahinor për Shëndetësi dhe Politikë Sociale i KSA të Kosovës (1976-1981), prodekan dhe më pas dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë (1981-1983). Në vitin 2009 u zgjodh profesor emeritus i Fakultetit të Mjekësisë. Konsiderohet meritore për fillimin e specializimeve nga mjekësia preventive në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1977), ishte kryeshef i katedrës së mjekësisë preventive për disa mandate, pastaj kryetar i Shoqatës së Mjekësisë së Punës së Kosovës, kryetar i Shoqatës së Mjekësisë së Punës të ish-Jugosllavisë dhe kryetar i Këshillit për Mbrojtjen dhe Përparimin e Ambientit të Kosovës në disa mandate. Botoi shumë punime shkencore dhe udhëhoqi një numër projektesh me interes për shëndetësinë publike të Kosovës. (Isuf Dedushaj)

BEGU Ajri (1951-2015). Shkrimtar, ekonomist. Lindi në Dibër, ku kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin. U diplomua në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare nga shkencat ekonomike në Universitetin e Zagrebit. Punoi në gazetën e studentëve "Bota e re" dhe më pas në Televizionin e Prishtinës. Pas vitit 1999 ishte guvernatori i

parë i Bankës Qendrore të Kosovës. Shkroi poezi, tregime, drama dhe studime nga fusha e ekonomisë. Botoi librat me poezi "Krasta" (1983), përmbledhjet me tregime "Tri net" (1975), "Gungat" (1976), "Uraniku" (1978), "Pehlivanët" (1987), dramat "Dyert" (1983) dhe "Gjarpri i shtëpisë" (1985). Drama "Gjarpri i shtëpisë" u realizua nga Teatri i Kombësive në Shkup. Në poezinë, por edhe në tregimet dhe dramat e tij mbisundon lidhja me vendlindjen, mbështetur te rrëfimet dhe trashëgimia gojore. (Eqrem Basha)

BEGU Ismet (1947-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kaçanoll të Mitrovicës, arsimimin bazë e mori në Mitrovicë dhe Vushtrri, ndërsa Fakultetin Ekonomik e përfundoi në Prishtinë më 1972. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Beogradit, ku kreu studimet pasuniversitare dhe më pas mbrojti doktoratën rreth shfrytëzimit të kapaciteteve dhe optimizmit të shpenzimeve në Trepçë. Në vitin 1972 filloi të punojë asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe më vonë po në këtë fakultet gradohet në të gjithë titujt universitarë. Ka një përvojë të gjerë në punën pedagogjike dhe profesionale. Mori pjesë në konferenca shkencore dhe botoi punime profesionale nga lëmi i mikroekonomisë. Gjithashtu botoi ligjërata të autorizuara dhe tekstet universitare "Ekonomia e ndërmarrjes" (1990) dhe "Teoria e prodhimit" (2005). (Florentina Xhelili-Krasniqi)

BEGUNCA Besnik (1972-1998). Pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Kaçanik. Mori pjesë në shumë aktivitete atdhetare që u zhvilluan në Kaçanik gjatë viteve '90. Në mars të vitit 1998 u inkua-drua në radhët e UÇK-së në Kaçanik. Më 4 gusht 1998 iu bashkua njësitit që përbëhej nga 23 luftëtarë, të cilët ishin përgatitur për të marrë pjesë në luftë kundër forcave serbe në Zonën Operative të Nerodimes në Jezerc. Më 10 gusht 1998, në fshatin Gabrricë, në një përleshje me forcat serbe, ra dëshmor së bashku me A. Bajramin dhe Xh. Kurtajn. (Skender Lutfiu)

BEHA Hamdi (1900-1948). Veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH) dhe i lëvizjes antikomuniste në Kosovë. Lindi në Tërstenë të Kamenicës. Ndërmjet dy luftërave botërore kundërshtoi pushtetin serb, sidomos kolonizimin e Kosovës,

ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore iu bashkua forcave nacionaliste. Gjatë viteve 1943 dhe 1944 mori pjesë aktive në organizimin dhe mbrojtjen e kufirit lindor të Kosovës kundër depërtimit të njësiteve çetnike e partizane serbe. Pas përfundimit të luftës dhe pas vendosjes së pushtetit komunist për një kohë u arratis në mal. Pas shpalljes së amnistisë së përgjithshme, u dorëzua te autoritetet komuniste, por u burgos. Bashkë me bashkëluftëtarë të tjerë, thyejnë burgun dhe u arratisën në mal. Më 1946 u bë anëtar i LNDSH-së. Gjatë kohës sa ishte në mal likuiduan disa bashkëpunëtorë të OZN-ës, të cilët kishin vrarë shumë nacionalistë shqiptarë. Pas një kohe të qëndrimit në ilegalitet, u kap nga OZN-a në Gjilan, bashkë me dy bashkëluftëtarë të tij. Gjyqi Ushtarak i Prishtinës e dënoi me vdekje dhe u ekzekutua në janar të vitit 1948. (Blerim Haziri)

BEHLULI Avni (1960-). Skulptor. Lindi në Breznicë të Bujanocit. Më 1986 mbaroi studimet në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, në drejtimin e skulpturës. Është ndër themeluesit e shkollës së mesme publike të artit pamor në Gjilan, ku më 2011 u emërua koordinator i saj. Veprat e tij gjenden në galeri e koleksione të ndryshme. Gjatë viteve '90 është shpallur krijues i vitit në Gjilan. Është fitues i disa çmimeve: Çmimi i Nëntorit (Maqedoni) nga SHAF "Draudakum, i Sallonit të Nëntorit, Prishtinë 2003, Çmimi "Shpërngulja plagë shekullore e popullit shqiptar", Prishtinë 1994, Çmimi i "Sallonit të të rinjve", Prishtinë 1987. Ka marrë pjesë në koloni e simpoziume në Egjipt, Turqi, Qipro, Shqipëri, Maqedoni e Kosovë. (Agim Rudi)

BEHLULI Demir (1938-). Pikturor, poet. Lindi në Ranatoc të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në Magjere e Preshevë, Shkollën Normale në Shkup, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e artit figurativ, në Prishtinë (1964). Mësimet për dizajn të perdeve të shtypura i zgjeroi në Kufshajtajn të Tiroilit (Austri). Një kohë ishte arsimtar i artit figurativ në Preshevë, më vonë dizajner në kombinatin e tekstilit në Gjilan, deri më 1990, kur u përjashtua nga regjimit serb. Punoi vepra arti që kanë qasje realiste. Pikturoi muralet në Kishën e Binçës dhe dekoroi disa xhami me arabeska. Ekspozoi në Preshevë, Shkup, Manastir, Beograd, Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Gjakovë e Prizren.

Botoi libra me poezi dhe ese: "Me këto duar", "Dielli-zog qielli", "Jehonë maji", "Udhëtimi", "Mbreti i shtëpisë", "Duke pritur", "Ese, kritika, ekspozita", "Arabeska origjinale në xhami të Kosovës Lindore", si dhe librat me tregime "Kur njeriu flet me vete", "Befasi e këndshme". Për punën e tij krijuese mori shpërblime dhe mirënjohje. (Rexhep Goçi)

BEHLULI Ibrahim (1952-). Mjek, anatomist, profesor universiteti. Lindi në Ranatoc të Preshevës, arsimimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Pas diplomimit punoi si mjek në Institutin e Anatomisë, kurse në vitin 1980 u zgjodh asistent i Anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në



IBRAHIM BEHLULI

Beograd më 1983. Mbrojti tezën e doktoratës nga fusha e anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 1987. Kreu detyra të ndryshme në Fakultetin e Mjekësisë dhe në organet drejtuese të Universitetit të Prishtinës. Ndërkohë kreu edhe specializimin për gjinekologji me obstetrikë në Fakultetin e Mjekësisë në Nish (1997). Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume ndërkombëtare dhe është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale. Është anëtar i bordit për licencime dhe specializime në Ministrinë e Shëndetësisë. Që nga viti 2001 është profesor i rregullt i anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Bajram Nuraj)

BEHLULI Mehmet (1962-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Prishtinë, ku kreu dhe Fakultetin e Arteve (1987). Organizoi disa ekspozita personale dhe, si anëtar i *Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës* mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive. Njëherësh qe kurator, publikues dhe hartues i projekteve artistike në Zagreb (1991), Cetinë (1998), Tiranë (1998), Berlin (2001),



MEHMET BEHLULI

Lubjanë (2001), Paris (2001), Stokholm (2001), Stamboll (2001), Zagreb (2001-2004), Tiranë (2012), Prishtinë (2012), Sarajevë (2015) etj. Është i njohur si krijues i ekspresionizmit dhe i figuracionit kompozicional me pasqyrime ideore-intelektuale në mediet e reja. Është fitues i disa çmimeve e mirënjohjeve: në Sallonin e Prishtinës, në Bienalen e Vizatimit, në Bienalen e të Rinjve etj. Më 2017 në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë hapi ekspozitën e tij retrospektive “S’ka si shpija” me pikura, instalime, video etj. Është mësimdhënës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku ligjëron lëndët teoria e hapësirës, arti konceptual dhe mediet e reja. (Hajrush Fazliu)

BEHLULI Shyhrete (1962-). Këngëtare popullore. Lindi në Mushtisht të Suharekës. Kreu shkollën fillor në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prizren. Afinitetin për këngën popullore folklorike e tregoi që në moshë të hershme. Paraqitjen e parë publike e pati me këngën “Cuca e maleve” më 1974. Në vitet 1987-1990 ka dhënë shumë koncerte në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni dhe diasporë. Ka botuar albumin “Gjuhë e bukur” me këngë patriotike (1987) dhe “Besa Besë” (1988) me këngë të tjera. Në vitet e mëvonshme u paraqit me këngë lirike (“Ti fanar i pushuar” 2003; “Moj fisnike” 2005; “Dasma kosovare” 2008; “Të kam mik, më ke mike” 2010; “Bija, o moj bija” 2007). Ka marrë pjesë në festivale dhe ka realizuar duete me Sh. Fejzën e M. Feratin. (Indira Çipa)

BEHRAMI Valon (1985-). Futbollist. Lindi në Mitrovicë. Kur ishte 5 vjeç bashkë me prindërit migroi në Zvicër. Filloi të luajë futboll në skuadrat lokale zvicerane. Pas një numri paraqitjesh me Luganon, u ble nga skuadra italiane “Genoa” në stinorin 2003/04, duke luajtur me ta në Serinë B. Në vitin 2004 iu bashkua skuadrës italiane “Udinese”, kurse në stinorin 2004-2005 “Gjenova” (Genoa) e huazoi te “Verona”, sërish në Serinë B. “Lacio” (Lazio) e bleu atë në vitin 2005. Më 19 mars 2008 emri i tij u vendos në historinë e “Lacios”, duke shënuar golin e fitores në minutën e 92-të kundër Romës. Në vitin 2008 “West Ham United” firmosi me Behramin një kontratë 5-vjeçare, ndërkohë në vitin 2011 Behrami kaloi te “Fiorentina”, duke nënshkruar kontratë 3-vjeçare. Një vit më vonë kaloi te “Napoli”, me të cilin në vitin 2014 fitoi trofeun e parë të karrierës, pasi “Napoli”

mposhti në finalen e Kupës së Italisë “Fiorentinën” Në edicionin 2014/15 luajti për skuadrën gjermane “Hamburger”, ndërsa në vitin 2015 u bë pjesë e skuadrës së njohur angleze “Watford”. (Baki Berisha)

BEHXHETI Sadi (1957-). Mjek, anatomist, profesor universiteti. Lindi në Lisec të Tetovës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mbaroi studimet pasuniversitare në Zagreb në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, seksioni i biomedicinës-neuroanatomisë. Po në këtë fakultet më 1987 mbrojti tezën e doktoratës. Në vitin 1986 u emërua asistent, pastaj me radhë mori titujt përkatës universitarë. Ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tetovës (2000-2002), rektor i Universitetit Shtetëror të Tetovës (2006-2009) dhe kryetar i komunës së Tetovës në periudhën 2009-2013. Publikoi shumë punime profesionale dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit, si autor dhe bashkautor. Është bashkautor i disa teksteve universitare (“Anatomia e njeriut, sistemi nervor qendror” etj.). Është profesor i rregullt i anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Bajram Nuraj)

BEJTA Bekim (1970-). Gjuhëtar, profesor universiteti, përkthyes. Lindi në Mitrovicë. U diplomua në Universitetin “Poitiers”, në Francë, ku kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit (2002). Është profesor në departamentin e gjuhës dhe të letërsisë angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Botoi librat: “Zgjidhja për theksin e fjalës të anglishtes” (The solution to English Word-Stres, Paris 2003), “Gjuha dhe të folurit” (2007), “Analiza fonologjike e huazimeve në anglisht” (Analyse phonologique des emprunts en anglais) (2009) dhe “Naturalizimi morfo-semantik i ksenizmave në anglishten” (Naturalisation morpho-sémantique des xénismes en anglais, 2009). Nga anglishtja në shqipen përktheu vepra të ndryshme angloamerikane, ndër to të Xhon Apdajk (John Updike), të Shekspirit, ndërsa nga frëngjishtja vepra të Paskal Roz dhe të J. M. G. Lë Klezio. Është shpallur kampion bote në karate në versionin WKA, kategoria deri 75 kg në Kampionatin Botëror të mbajtur në Huelva të Spanjës më 2009. (Ardita Berisha)

BEJTA Murat (1937-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Podujevë. Studimet universitare në fushën e filologjisë romane i përfundoi në Beograd dhe Zagreb (1960-1974).



MURAT BEJTA

Tezën e disertacionit e mbrojti në Prishtinë (1980) rreth huazimeve romane në gjuhën shqipe. Punoi si profesor në shkollat e mesme të Mitrovicës, ku ishte edhe drejtor gjimnazi. Në vitet 1972-1991 ishte profesor në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Është marrë kryesisht me leksikografi dhe leksikologji. Është autor i “Fjalorit frëngjisht-shqip” të botuar më 1978 dhe shkroi artikuj të ndryshëm nga fusha e gjuhësisë. Përktheu nga frëngjishtja veprën “Parime të fonologjisë” të N. S. Trubeckoit. (Ardita Berisha)

BEJTA-GALICA Azem (1889-1924). Luftëtar në lëvizjen antiosmane dhe prijës i çetave të armatosura kundër Serbisë dhe Malit të Zi pas vitit 1912. Lindi në Galicë të Drenicës. I



AZEM
BEJTA-GALICA

ati, Bejta, u vra më 1907 në luftë kundër ushtrisë osmane. Ishte bashkëluftëtar i A. Delisë së Prekazit. Në nëntor të vitit 1912, bashkë me 26 vushtrria zihet rob nga ushtria serbe, dërgohet në llogore në Zajëçar e pastaj në burgun e Pozharevcit, nga i cili u arratis bashkë me shokë në vitin 1915, për t’iu bashkuar çetave kaçake. Bashkëpunoi me Shaqir Smakën deri në vrasjen e tij më 1917. Nga kjo kohë ai del në krye të çetave. Më 1915 martohet me Qerime Halilin-Shotën, nga Radisheva, me të cilën ishte njohur para se të binte në burgjet serbe. Në qershor të vitit 1915, bashkë me vëllezër dhe Shotën e bën luftën e parë kundër ushtrisë serbe. Po atë vit u njoh me Hasan Prishtinën dhe Bajram Currin, të cilëve iu mbeti besnik deri në vdekje. Me themelimin e Komitetit të Kosovës në nëntor 1918, emërohet komandant i çetave të armatosura. Në prill-qershor të vitit 1919 udhëhoqi kryengritjen e përgjithshme kundër Serbisë, ku morën pjesë mbi 10 mijë kryengritës. Më

1920, me sugjerimin e Komitetit të Kosovës, organizoi Kuvendin e Murgullës. Si prijës i çetave, pati rol në formimin e Zonës Neutrale të Junikut. Më 1923, pas shuarjes së kësaj zone, formoi Zonën e Lirë të Drenicës, në fillim në komunën e Prekazit e pastaj e ngushtuar në tri fshatra: Galicë-Mikushnicë-Lubavec, deri në korrik të vitit 1924, kur u sulmua me 2,000 forca të ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe. Fshatrat u shkatërruan tërësisht, pati edhe shumë viktima. A. Bejta u plagos rëndë, disa ditë jetoi në Çiçavicë, pastaj me bashkëluftëtarë kaloi në malet e Perçevës. Vdiq nga plagët e marra. Që kufoma të mos binte në duart e armikut, nga shokët e tij u varros në shpellë. Më 1971 eshtrat e tij u gjetën nga mësuesi Abdyl Krasniqi dhe u varrosën në Galicë. (Liman Rushiti)

BEJTULI-KICA Nevzat (1962-). Piktur. Lindi në Gjurgjevisht të Gostivarit. Kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Shkup. Hapi ekspozita individuale brenda dhe jashtë vendit. Në krijimtarinë e tij i referohet njeriut dhe kalit, të cilët në pikturat e tij kanë marrëdhënie reciproke. Reflektimi i objektit të figuracionit të tij ndonjëherë tretet edhe në abstraksion, që në një mënyrë e paraqet sfondin e përjetimeve të përditshmërisë shqiptare. Gjatë vitit 2012 ishte i pranishëm edhe me një performancë vizive gjatë aktivitetit “Shiko muzikë, dëgjo pikturë, fito libër”. Është fitues i çmimit “Petar Mazev” në Shkup nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Maqedonisë (2006). Në vitin 2011 mori çmim për skulpturën e Nexhat Agollit në projektin “Shkupi 2014”. (Jëlldeze Asani)

BEJTULLAHU Alma (1972-). Muzikologe. Lindi në Prishtinë, ku mori arsimin fillor e të mesëm. Kreu studimet universitare e pasuniversitare të muzikologjisë në Lubjanë. Vazhdoi studimet e doktoratës nga antropologjia sociale në Institutin e Shkencave Humanistike po në Lubjanë. Hulumton në fushën e etnomuzikologjisë, interpretimeve muzikore, pedagogjike, promovimin e muzikës dhe kulturës shqiptare. Është pjesëmarrëse me kumtesa në konferenca etnomuzikologjike ndërkombëtare. Ka botuar punime për këndimin e femrave në viset rurale të Kosovës (Vjenë), për muzikën e emigrantëve katolikë nga Kosova (Zagreb), për çiftelinë dhe rolin e saj në shoqëritë rurale dhe urbane të Kosovës (Tiranë), për muzikën popullore shqipe në Maqedoni (Shkup), si dhe

paraqitje të tjera në konferenca shkencore në Paris, Cyrih, Berlin etj. Është autore, redaktore dhe recensente tekstesh shkollore muzikore në Slloveni, ligjëruese mysafire në universitete të ndryshme dhe mësimdhënëse në shkollat shqipe në Slloveni. Jeton e vepron në Lubjanë. (Indira Çipa)

BEJTULLAHU Emrush (1934-2015). Logoped, profesor universiteti. Lindi në Përlepnice të Gjilanit. Arsimimin bazë e mori në Gjilan dhe në Gjakovë. U emërua mësues në Gjilan



EMRUSH
BEJTULLAHU

dhe Lashticë. Në vitin 1952 u burgos për arsye politike. Pas vuajtjes së dënimit prej dy vjetësh, më 1954 u punësua në Gjimnazin e ulët të Tugjecit. Në vitin 1956 u burgos sërish. Pas lirimit nga burgu (1959) u largua

për në Zagreb, ku kreu Fakultetin e Defektologjisë (logopedinë) dhe studimet pasuniversitare. Aty kreu edhe specializimin për rehabilitimin e fëmijëve me ngecje në zhvillimin psikofizik dhe mental. E. Bejtullahu është themeluesi i logopedisë në Kosovë. Më 1970 punoi në shkollën e të verbërve "Migjeni" në Prishtinë, ku ishte hapur ambulanca e parë e logopedisë në Kosovë. Më 1972 sërish u largua nga puna. Një vit më vonë, me hapjen e ambulancës logopedike në Klinikën e Otorinologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe më vonë me shndërrimin e ambulancës në repart në kuadër të kësaj klinike, E. Bejtullahu u përfshi në stafin profesional të këtij reparti, më vonë edhe të Qendrës së Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të të Folurit në Fakultetin të Mjekësisë në Prishtinë. Është autor i tekstit "Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimin". (Valbona Govori)

BEJTULLAHU Rasim (1948-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin (1966). Kreu studimet për fizikë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1970). Një kohë të shkurtër punoi mësimdhënësi i fizikës në gjimnazin e Gjakovës, pastaj në vitin 1971 zgjidhet asistent në katedrën e fizikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në



RASIM
BEJTULLAHU

FSHMN të Universitetit të Shkupit (1973), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës, nga fusha e fizikës optike, e mbrojtë në FSHMN të UP-së (1976). Është autor i teksteve për shkolla të mesme dhe i teksteve universitare ("Përmbledhje detyrash të zgjidhura të mekanikës teorike", "Fizikë teorike"). Ka marrë pjesë në tubime shkencore nga fusha e fizikës, të organizuara në vend dhe në botën e jashtme. (Rexhep Gashi)

BEJTULLAHU Zeki (1939-2016). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Agronomisë të Universitetit të Shkupit më 1961. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin Ekonomik të Shkupit. Për shumë vjet ishte profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Doktoroi në Fakultetin Ekonomik të



ZEKI BEJTULLAHU

Universitetit të Beogradit në fushën e sistemit ekonomik (1976). Ushtri detyra të ndryshme profesionale nga fushëveprimi i agronomisë dhe ekonomisë në nivele të ndryshme të administratës së ish-Jugosllavisë. Që herët filloi të merrej edhe me veprimtari artistike. Nga fusha e ekonomisë është autor dhe bashkautor i disa teksteve universitare dhe i librave shkencorë: "Ekonomia e bujqësisë" (1983), "Ndërrimet strukturale dhe punësimi" (1985), "Strategjia në biznes dhe bazat e biznesit të përparuar" (1994) etj. Botoi edhe një numër punimesh shkencore, shumica të publikuara jashtë Kosovës. Mori pjesë në simpoziume, seminare, konferenca shkencore ndërkombëtare dhe vendore. Në fushën e artit figurativ, si autodidakt, gjithashtu zhvilloi një veprimtari të gjerë. Ka organizuar ekspozita personale të pikturave në Prishtinë, Zagreb, Beograd, Dubrovnik etj. (Myrrete Badivuku- Pantina)

BEKA Abdinaser (1967-). Aktor. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Fillimisht ndoqi studimet për letërsi

dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, ndërkaq studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1994). Në Teatrin “Dodona” luajti në shfaqjet: “Profesor, jam talent se jo mahi 1” (1991), “Tregimi zoologjik” (1993) dhe “Borgjezi fisnik” (1993). Në Teatrin “Loja”, në Muni (Gjermani), luajti në shfaqjet: “Zogu i shqiptarit dhe zogu i gomarit” (1998) dhe “Për gruan dhe tokën e jap edhe kokën” (1999). Në teatrin e Mitrovicës luajti në shfaqjen “Vetmi në Perëndim”. Luajti gjithashtu në filmat: “Atje ku nuk lind dielli”, “AD”, “Babai” etj. Jeton dhe punon në Muni. (Naime Beqiraj)

BEKA Fadil (1962-). Mjek i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Ticë të komunës së Skënderajt. Kreu studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës në vitin 1990. Në periudhën 1990-1994 punoi si mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Skënderaj dhe më pas specializoi në Tiranë për kirurgji të përgjithshme. Në luftë u inkuadrua në shkurt të vitit 1998. Punën si mjek i luftës, specialist i kirurgjisë, e filloi së pari në shtëpinë e tij në Ticë, pas betejës së Likoshanit, ku shëroi luftëtarët e parë të plagosur të UÇK-së. Më pas kontribuoi në ngritjen e sistemit shëndetësor në radhët e UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në korrik të vitit 1998 e emëroi shef të spitalit të parë ushtarak në Likoc, në Zonën Operative të Drenicës, ndërsa në shkurt të vitit 1999 u emërua shef i sektorit të shëndetësisë të UÇK-së. Pas luftës kreu një sërë funksionesh në institucionet e shëndetësisë në Kosovë. Në legjislaturën e pestë u zgjodh deputet i Partisë Demokratike në Kuvendin e Republikës së Kosovës. (Sabit Sylja)

BEKOLLI Zeqir (1956-). Gazetar. Lindi në Korroticë të Drenasit. Studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i kreu në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1981). Punoi mësimdhënës në Drenas, ndërsa nga viti 1985 korrespondent i gazetës “Rilindja” të Prishtinës dhe më pas, deri më 1988, gazetar në redaksinë e gazetës “Bujku”. Në periudhën 1998/99 raportoi për zhvillimet në zonat e luftës. Pas vitit 1999 ishte redaktor dhe zëvendëskryeredaktor në gazetën “Rilindja”. Botoi librat publicistikë “Drenica në stinët e UÇK-së” (1998), “Të pathënat për luftën e Kosovës”, një album me afro 500 fotografi lufte

“Dëshmi për krimin serb në Kosovë” (2014). Botoi edhe dramën “Krismat e lirisë” (2001) dhe romanin “Fatet tragjike” (2006). Punon në Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës. (Veli Bytyçi)

BEKSAÇ Zejnel (1952-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prizren. Kreu shkollën e mesme në vendlindje. Punoi në gazetën “Tan” dhe në Radiotelevizionin e Prishtinës, ku përgatiste emisione kulturore, artistike dhe dokumentare. Që kur ishte fëmijë, botoi poezi në gazetën “Birlik” të Shkupit. Në Shoqatën “Dogru Yol” të Prizrenit drejtoi dhe aktivitetet letrare. Botoi librat: “Mburru shekulli 20” (1980), “Nëse e kërkoni ngjyrën e dashurisë” (1982), “A fle plepi?” (1987), “Dashuri e ndërlikuar” (1990), “Dielli së pari lind për dashuri” (1995) etj. Më 1987 në Izmir fitoi një çmim për poezi. Z. Beksaç gjithashtu është piktor dhe kompozitor. (Irfan Morina)

BEKTASHI Alma (1972-). Mezosoprano. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës në Prishtinë, drejtimi piano, Akademinë e Arteve, dega e solokëndimit në Tiranë, ku kreu dhe specializimin për muzikë kamerale. Dy vjet punoi në Teatrin e Operës e Baletit në Tiranë. Shquhet për timbër të veçantë dhe ndjeshmëri interpretimi. Repertori i saj u pasurua me paraqitje si soliste me ansamble e orkestra të vendit dhe ndërkombëtare. Sukseset lidhen me interpretimin e roleve në vepra si: “Samsoni e Dalila” të Rosinit, “Karmen” të Bizet, “Endrra e një nate vere” të Mendelsonit, “Matheus pasion” të Bahut etj. Ka realizuar turne në Itali, Greqi, Zvicër, Francë dhe ka bashkëpunuar me dirigjentë të shquar. Si pjesëmarrës në Festivalin “Kënga në Radiotelevizion” është nderuar me çmime të rëndësishme, pastaj në mjuziklin “Romeo e Xhuljeta” etj. Aktiviteti i saj lidhet dhe me angazhimin pedagogjik për kultivimin e vokalit të nxënësve dhe studentëve. Punon në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ka botuar librin “Aktori dhe zëri - elementet e teknikës vokale”. (Sami Piraj)

BEKTASHIZMI. Rrugë e misticizmit islam, që u shfaq në shek. XIII në Anadoll. Themelues i saj ishte Haxhi Bektash Veliu, një nga urtarët e Horasanit, i cili në kohën e okupimit mongol u vendos në Suluxha Karahojuk (Haxhi

Bektashin e sotshëm), në afërsi të qytetit Nevshahir të Turqisë. Bektashizmi e vazhdoi aktivitetin shpirtëror dhe shoqëror deri në vitin 1826, kur me suspendimin e jeniçerëve, sulltan Mahmudi II mbylli edhe teqetë bektashiane dhe një numër syresh u zhvendosën në viset shqiptare, veçmas në pashallëkun e Ali pashë Tepelenës. Që atëherë viset shqiptare u shndërruan në vatër kryesore të bektashizmit. Periudha e veprimit gjysmëlegal zgjati një shekull, kur Ataturku në vitin 1925 i mbylli të gjitha teqetë në Republikën e Turqisë. Si rrjedhojë, kryegjyshi i atëhershëm i kryegjyshit bektashiane Salih Nijazi Dedeu, me origjinë shqiptare, kaloi në Tiranë, duke bartur me vete edhe qendrën e kryegjyshit bektashiane botërore, ku vazhdon të qëndrojë edhe sot e kësaj dite. Bektashizmi është një ndër rrugët mistike islame më të përfaqësuara te shqiptarët dhe, që nga fillimi, mori pjesë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore shqiptare. Për shkak të sjelljeve më liberale të adhurimeve fetare islame, që erdhën si pasojë e baticave dhe zbatimit politik, u pranua si një prej rrugëve mistike më heterodokse. Burimet themeltare të kësaj rruge mistike të islamit e paraqesin bektashizmin si shumë të përpiktë në parimet e përgjithshme të botëkuptimit të moderuar islam. (Metin Izeti)

BEKTESHI Abdullah (1948-). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Smirë të Vitisë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Viti, kurse studimet në Fakultetin e Xehetarisë të Universitetit të Sarajevës (1973). U punësua si inxhinier në minierën e Hajvalisë, ku punoi si udhëheqës teknik në minierë. Pastaj kreu një varg detyrash udhëheqëse: drejtor i minierës së Hajvalisë (1977), drejtor i organizatës në minierat Hajvali me Kishnicë (1980) dhe në vitin 1984 drejtor i organizatës punuese minierat me flotacion Kishnica me Novobërdë. Në vitin 1990 u largua me dhunë nga puna. Nga viti 1992 jeton në Gjermani. (Shyqeri Kelmendi)

BEKTESHI Bektesh (1943-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Zhegër, Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën normale në Gjilan. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, magjistroi në Fakultetin Filozofik të Zagrebit (1975) dhe doktoroi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës

(1987). Fillimisht ishte mësues në fshatin Shurdhan, pastaj pedagog në Entin për Punë Sociale në Prishtinë, vazhdoi mësimdhënës në gjimnazin e Prishtinës dhe të Lipjanit. Një kohë punoi edhe në Institutin Andragogjik, Pedagogjik dhe Psikologjik në Beograd. Në vitin 1972 fillon punën si asistent në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, ku arriti të gjithë titujt universitarë. Mbajti mësim edhe në Universitetin e Tetovës dhe në kolegje private në Kosovë. Fushë e interesimit të tij në mënyrë të veçantë është metodologjia e pedagogjisë. Ishte pjesëmarrës projektsh të hulumtimit dhe trajnimit, organizator i punës kërkimore-shkencore të studentëve të pedagogjisë dhe redaktor i revistës së tyre "Dija". Ndër veprat e botuara veçohen: "Statistika elementare" (2001) dhe "Mbingarkimi i nxënësve me mësim në shkollë" (2009). (Januz Dervodeli)

BEKTESHI Kushtrim (1982-). Regjisor, dramaturg. Lindi në Kumanovë. Shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet për regji teatri i kreu në Fakultetin e Arteve të



KUSHTRIM
BEKTESHI

Universitetit të Shkupit (2008). Bëri regjinë e disa shfaqjeve në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri, sikurse: "Akuariumi" të R. Abazit (2006), "Labirinhet e kujtesës" nga A. Halimi (2007), "Vojceku" nga G. Bihner-i (2008), "Figaro shkurorëzohet" nga Horvath-i (2008), "Kurthi i vdekjes" të I. Levin-it (2009), "Kush ka frikë nga Virginia Wolf?" nga E. Albee (2009), "Mirandolina" nga C. Goldoni (2012), "Shtëpi në erë" nga S. Çapaliku (2012), "Konkursi" (2013) dhe "Vdekja aksidentale e një anarkisti" nga D. Fo (2014) etj. Është regjisor dhe skenarist i filmave me metrazh të shkurtër "Vdekja e mjellmës" (2011) dhe "Diletanti" (2013) dhe i filmit me metrazh të gjatë "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" (2015). Ka qenë pjesëmarrës në disa projekte ndërkombëtare dhe është fitues i disa çmimeve për punë regjisoriale, brenda dhe jashtë vendit. Punon si asistent në Fakultetin e Arteve në Shkup dhe bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. (Salajdin Salihu)

BELEGOVIQ Seida (1955-). Grafiste, publiciste. Lindi në Podgoricë. Kreu Akademinë e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës, në Prishtinë. Në vitin 1988 qëndroi në Paris si bursiste e Fondit “Mosha Pijade”. Mori pjesë në mbi 2000 ekspozita kolektive dhe në disa koloni artistike. Hapi këto ekspozita personale: 1979 në Paliq, 1988 në Paris, 1989 në Budvë, Tivar dhe Shën Stefan, 1991 në Podgoricë, Kotorr, Plavë, Herceg Novi, Nikshiq dhe Gorazhde, 1994 në Petrovc, 1996 në Nish e Podgoricë, 1997 në Beograd, Plavë, 1998 në Ulqin, Sarajevë dhe Cele, më 2008-9 në B. Polje, Herceg Novi, Mojkovc, Prishtinë dhe më 2011 në Tuz. Mori shumë mirënjohje e shpërblime për pikturë, karikaturë dhe grafikë. Merret dhe me publicistikë. Është anëtare e SHAF dhe e Shoqatës së Pedagogëve e Gazetarëve të Malit të Zi. Udhëheq të rinjtë në “Zgjimi piktural” në Podgoricë. (Basri Mekolli)

BELEGU Ekrem (1948-). Inxhinier, menaxher. Lindi në Pejë, ku kreu arsimimin bazë. Kreu studimet për inxhinieri elektrike në Universitetin e Lubjanës dhe të Zagrebit. Filloi punën si projektues dhe mbikëqyrës i instalimeve elektrike në Entin për Urbanizëm dhe Projektim në Pejë (1973-1978), më pas udhëhoqi ekipin inxhinierëve për ndërtimin dhe funksionalizimin e fabrikës së baterive industriale “Trepça” po në Pejë. Ishte drejtor teknik, kurse më vonë drejtor i përgjithshëm i kësaj fabrike (1978-1989). Për shkaqe politike, në mars të vitit 1989 burgoset dhe largohet nga puna, ndërsa në fabrikë vendosen masat e dhunshme. Një kohë punoi si inxhinier operativ në ndërmarrjen “Melbat” të Novi-Sadit. Më pas themeloi firmën e vet, e cila merrej me organizimin e punëve tregtare (1993-1999). Pas vitit 1999 kthehet në fabrikën e baterive “Trepça” si ndihmësdrejtor dhe drejtor i përgjithshëm, deri në privatizimin e saj (2013). Pas privatizimit të fabrikës, E. Belegu emërohet drejtor menaxhues, ku punon edhe tani. Si ekspert i energjisë është angazhuar në firma e projekte të ndryshme nga lëmi i energjisë. (Ali Hamiti).

BELEGU Mazllum (1945-). Mjek, transfuziolog, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, studimet i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1969).



MAZLLUM BELEGU

Në fillim punoi në Spitalin e Sëmundjes së Mushkërive në Pejë. Kreu specializimin nga transfuziologjia në Entin për Transfuzionin e Gjakut të Serbisë në Beograd, ku i kreu edhe studimet pasuniversitare (1977). Mbrojti doktoratën në vitin 1980 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1980-1981 bëri studime postdoktorale në SHBA. Nga viti 1972 e deri në vitin 1990 ishte kryeshef i Qendrës për Transfuzion në Prishtinë, nga ku u largua nga pushteti serb. Që nga viti 1972 dha mësim, së pari si asistent, pastaj me tituj të radhës deri te profesor ordinar i fiziologjisë patologjike dhe transfuziologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Pas luftës për një kohë të shkurtër (1999-2000) mbajti pozitën e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, ndërsa nga viti 2001 ishte drejtor i Qendrës Kombëtare për Transfuzion të Kosovës deri në pensionim (2010). Nga viti 1997 është bashkëkryetar i Asociacionit të Antropologëve Shqiptarë. Botoi dhjetëra punime si autor dhe bashkautor. Përveç shkrimeve autoriale, përktheu edhe tekste shkollore nga lëmi i mjekësisë. (Ismajl Dreshaj)

BELEGU Mithat (1938-). Basketbollist, gjyqtar ndërkombëtar. Lindi në Pejë. Filloi të merret me basketboll që nga viti 1950, përkatësisht 1954 në KB “Buduqnosti” të Pejës, që atëbotë ishte anëtar i ligës së Serbisë dhe ligës së parë federative të Jugosllavisë. Për shumë vjet u identifikua si realizator më i mirë i këtyre ligave, meqë në një ndeshje shënoi deri në 68 pikë, që ishte rekord i ish-Jugosllavisë. Në vitin 1971, pasi i jep fund karrierës së basketbollistit aktiv, merr titullin e gjyqtarit federativ, ndërsa në vitin 1976 merr titullin e gjyqtarit të FIBA-s. Gjatë këtyre 10 vjetëve si gjyqtar i FIBA-s, gjykoi ndeshje të kupës së kampionëve, kupës së fituesve të kupave, në kampionatet europiane dhe ballkanike, në afro 40 shtete të botës. Është gjyqtari i parë ndërkombëtar në Kosovë. Në stinorin 1993/94 angazhohet në krye të shtabit teknik të KB “Peja”, ku për tri vite me radhë skuadra fiton titullin e kampionit. Ishte themelues i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës dhe për shumë vjet kryetar i saj. (Rifat Gjonbalaj)

BELEGU Muhamet (1927-2014). Pedagog, drejtues orkestrinash. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu Shkollën e Lartë të Muzikës në Zagreb më 1953. Përfundoi Akademinë e Muzikës në Sarajevë më 1971, ndërsa studimet e magjistraturës i mbaroi në Institutin Pedagogjik Muzikor “Gnjësinih” në Moskë. Po aty përfundoi dhe studimet e doktoratës (1983). I kushtoi rëndësi edukimit muzikor të të rinjve. Punën pedagogjike e filloi në gjimnazin e Pejës, më pas kaloi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në Gjakovë dhe në Gjilan. Krahas punës pedagogjike udhëhoqi korin dhe orkestrën e mandolinatave në shkollën industriale “N. Tesla” në Zagreb, pastaj kuartetin e mandolinave në Operën e Sarajevës. Drejtoi korin, orkestrën frymore dhe të mandolinatave të Shoqërisë kulturore-artistike “Ramiz Sadiku” në Pejë dhe themeloi Ansamblin “Harmonia” në Prishtinë. Me kor e orkestër mandolinatash u paraqit në festivale e manifestime kulturore, në turne nëpër vende të ish-Jugosllavisë. Realizoi 30 këngë me këngëtarë të ndryshëm, që janë shfaqur në Radiotelevizionin e Prishtinës. (Reze Kryeziu-Breznica)

BELEGU Nevzat (1946-1992). Grafist, piktor. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1975). Kreu studimet pasuniversitare në Akademinë e Arteve Figurative në Vjenë (1979). Organizoi një sërë ekspozitash personale në Galerinë BBK-së në Munihi në Gjermani. Është pjesëmarrës në shumë ekspozita kolektive të Shoqatës së Artistëve Bavarezë, ekspozita vendore dhe rajonale të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës, ku edhe mori çmimin e Sallonit XIII Pranveror të Kosovës. Në vitin 1997 u organizua ekspozita pas vdekjes, në Galerinë “Europa” në Pejë. Një ekspozitë e veprave të tij u organizua edhe në vitin 2016 në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë. Vdiq në Munihi të Gjermanisë. (Basri Mekolli)

BELEGU Xhafer (1904-1962). Historian dhe diplomat. Lindi në Elbasan. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Më pas studioi në Linc të Austrisë, në Akademinë Tregtare. Më 1928 u kthye në Shqipëri dhe u emërua kryellogaritar i kryeministrisë. Kreu një varg detyrash politike, profesionale e shtetërore.

Në vitin 1929 u emërua korrier diplomatik në Ministrinë e Jashtme. Një kohë ka kryer detyrën e konsullit në Manastir. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore u kthye në Shqipëri dhe përkrahu Lëvizjen Antifashiste. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte i përndjekur. Punoi si llogaritar e revizor në Elbasan e Cërrik, punëtor krahu në ndërtim dhe në fidanishten pyjore. U mor intensivisht me studimin e historisë së popullit shqiptar. Arriti të botonte vetëm monografinë “Lidhja e Prizrenit” (Tiranë, 1939 dhe 1940), që ishte studimi i parë monografik për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Ka lënë edhe disa vepra në dorëshkrim, si: “Jeta e Ali Pashë Tepelenës”, “Principatat shqiptare”, “Origjina e Aleksandrit të Maqedonisë”, “Studime mbi Pellazgët”, “Mendime filozofike mbi klasikët grekë”, “Mehmet Ali Pasha, mbret i fellahëve”. Vdiq në Elbasan. (Teki Kurti)

BELICI Domeniko (Domenico Bellizi) (1918-1989). Poet arbëresh, i njohur me pseudonimin Vorea Ujko. Lindi në Frasinë të Kalabrisë, në Itali. Ishte prift, studioi për letërsi dhe punoi si mësues në Firmo. Bellici, ashtu si autorët e tjerë arbëreshë, bëri përpjekje që me anë të gjuhës së veprës së tij ta kultivonte gjuhën e tij arbëreshe dhe gjithashtu t'i afrohej shqipes që flitej në Shqipëri. Veprat e tij u botuan në shumë antologji dhe periodikë të ndryshëm në Itali, Shqipëri dhe në Kosovë. Veprat “Zgjimet e gjakut” (1971), “Kosovë” (1973), “Mote moderne” (1976) dhe “Stinët e mia” (1980) janë botuar në Itali; “Ankth” (1978) u botua në Kosovë dhe “Këngë arbëreshe” (1982); “Burimi” (1985) dhe “Hapma derën, zonja mëmë” (1990) u botuan në Tiranë. Mbahet ndër poetët e rëndësishëm arbëreshë. (Ardita Berisha)

BELTON Majra (Mira Beltran) (1960-). Balerinë nga Filipinet. Lindi në Manila. Ka dhënë kontribut të veçantë në shfaqjet e trupës së baletit në kuadër të Teatrit Popullor Krahinor. Në mesin e shumë kreacioneve të saj skenike u veçua për rolet: Mbretëresha në “Interplay” të autorit Morton Gullti (1984), Gruaja e komandantit në “Era dhe kolona” të kompozitorit Akil Koci (1983), E dashura në “Kënga e Rexhës” të Akil Kocit (1983), Zhulieta në “Romeo dhe Zhulieta” të A.P.Çajkovskit etj. (Arian Krasniqi)

BELUSHO Xhovani (Giovanni Mario Giacomo Belluscio) (1961-). Fonetikan, gjuhëtar, profesor. Lindi në komunitetin arbëresh të Shën Vasilit, Kalabri. U diplomua për gjuhë dhe letërsi të huaja moderne me specializim në fushën e fonetikës eksperimentale në Universitetin e Kalabrisë, ku i kreu edhe studimet doktorale (1993). Aty vijoi punën si kërkues shkencor, pedagog i gjuhës shqipe dhe i dialekteve arbëreshe. Ndërkohë, punoi në Liceun e Shën Mitrit (1999), në Universitetin e Leçes (1997-2000), të Barit (2002-2004). Kërkimet e tij janë përqendruar në studimet dialektore të arbëreshëve të Italisë, në fonetikën eksperimentale të zbatuar në shqipen dhe të folmet arbëreshe, në leksikologji e leksikografi të shqipes, si dhe në analizë teksti lidhur me konkordancat elektronike të teksteve letrare shqipe. Ka marrë pjesë në projekte hulumtuese. Ndër studimet e tij veçohen: “Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë, shqip-italisht-frëngjisht-anglisht” (2011, bashkautor), “Gjuha shqipe në arsim në Itali” (The Albanian Language in Education in Italy, 2010). Është anëtar i bordit të INA-s (International Network of Albanology). (Aljula Jubani)

BELLA Ahmet S. (1949-). Pedagog, muzikolog, kompozitor. Lindi në Zabel të Ulët të Drenicës. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. U diplomua në Akademinë e Muzikës, drejtimi teoriko-pedagogjik, në Zagreb. Udhëhoqi grupin e studentëve “Shkëndija” në Zagreb dhe realizoi koncerte. Pas studimeve ishte pedagog në gjimnazin e Drenasit. Kreu Muzikologjinë në Universitetin e Hagës, studioi për solokëndim (realizoi role operistike), si dhe dy vjet kompozim. Në Skandinavi udhëhoqi korin “Collegium Musicum”, me koncerte. Ligiëroi muzikologjinë në Universitetin e Lundit. Organizator i jetës kulturore të shoqërive kulturore të shqiptarëve në Suedi, sekretar i Unionit të Shoqatave të atjeshme, organizues i Festivalit të Poezisë-Muzikës me vepra të autorëve tanë dhe të diasporës. Kompozoi këngë në frymën popullore, me të cilat u shpërblye në Akordet e Kosovës, pastaj fuga për piano, arie për zë e piano, këngë korale, sonata për violonçel, “Elegji për O. Palmen”, poema “Dardania”. Shkroi punime muzikologjike dhe një antologji me veprat muzikore të Kosovës, botuar në Malmo. Është anëtar i asociacionit të muzikologëve suedezë. (Zeqirja Ballata)

BELLAQECI. Fshat në perëndim të Fushë-Kosovës, 9.5 km larg nga qendra komunale. Shtrihet në anën e majtë të lumit Sitnica, në lartësi mbidetare 550 m. Është vendbanim i tipit të dendur, me zonën kadastrale prej 1,134 ha. U themelua në lokalitetin e vendbanimit të lashtë (lokaliteti Gradina) të shekullit VIII p.e.s. Me këtë emër përmendet në krisobulën e Manastirit të Deçanit në vitin 1326. Në vitin 1014 kishte 586 banorë, në vitin 1991 kishte 3,049 banorë, kurse tani në të jetojnë rreth 4,000 banorë. Një pjesë e zonës kadastrale është e përfshirë nga mihjet sipërfaqësore të linjtit, ku punon një numër i konsiderueshëm i banorëve lokalë. Është bashkësi lokale e disa vendbanimeve përreth. Ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, qendrën e bashkësisë lokale, stacionin shëndetësor, bibliotekën, disa njësi tregtare etj. (Ibrahim Ramadani)

BELLASICA-VËRHLABI (Bielasiza, Bilasica, Bilasiza, Ballasiza etj.). Qytet dhe fortifikatë e rëndësishme e shek. XV, në kuadër të pellgut xehetar të Kopaonikut Juglindor dhe



FORTIFIKATA BELLASICA-VËRHLABI

Llapit Veriperëndimor, i themeluar në trasenë e rrugëve që lidhnin bregdetin me hinterlandin. I njohur nga antikiteti i vonë si Labutza ose Belas, i ngritur mu afër burimit të Llapit, sot është fshat i vogël, përkatësisht mëhallë në kuadrin e fshatit Murgull, rreth 35 km në veriperëndim të Podujevës. Këtu, skaj lumit, gjenden mbetjet e një vendbanimi të moçëm. Duke marrë

parasysh pozitën e vendbanimit si dhe njoftimet nga burimet historike, që në fund të shek. XIX identifikohet (ubikohet) për mbetje të Vërhlabit, përkatësisht të Bellasicës. Për ekzistimin e këtij qyteti dhe të kolonisë raguzane brenda tij ruhen edhe të dhëna arkivore. Dokumentet e vitit 1426 dëshmojnë se Bellasica për nga rëndësia vinte menjëherë pas Trepçës, e cila kishte në krye kefalium. Bellasica ishte e njohur edhe si qendër kishtarë romano-katolike me famulli dhe kishë monumentale kushtuar Shën Gregorit. Nga burimet materiale dhe burimet e shkruara është vërtetuar se një pjesë e Bellasicës është ngritur mbi gërmadhat e një oborri ose fortifikate, e cila në kohën e mbretit të Rashës, Milutinit, është quajtur Vërhlab. Në periudhën 1424-1448 qeveria raguzane kishte emëruar 11 konsuj, të cilët shoqëroheshin me 22 gjykatës nga radhët e raguzanëve, që jetonin në Bellasicë ose në vende të afërta. Përveç konsullatës, në qytet përmendet dhe një “fraterna kompania”, që zotëronte disa shtëpi dhe shkritore xehesh. Xehoret e Bellasicës dhe të rretheve ishin të pasura me ar dhe argjend. (Jahja Drançolli)

BELLÇISHTA Nehat (1933-2012). Mësimdhënës, veprimtar i arsimit. Lindi në Dibër, ku kreu edhe shkollën fillore. Dy vitet e para të shkollës së mesme i kreu në Tiranë dhe u diplomua në Normalen e Shkupit. Studioi dhe diplomoi në degën e albanologjisë në Fakultetin Filozofik të Beogradit. Punën si mësues e filloi në fshatin Vrapçisht të Gostivarit. U shqua edhe si futbollist, fillimisht në Gostivar, pastaj në Dibër. Pas studimeve punon si mësimdhënës i gjuhës shqipe në Dibër. Kontribuoi për themelimin e gjimnazit të Dibrës, ku ishte mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, i gjuhës latine etj. U shqua për punën e tij 40-vjeçare në arsim, me profesionalizëm dhe me përkushtim. (Myqereme Rusi)

BELLOBËRDA. Fshat në komunën e Leposaviqit, 15 km në veri nga qendra. Shtrihet pranë shpateve lindore të Kopaonikut. Për shkak të shfrytëzimit të xeheve qysh në shek. XIV dhe XV kishte disa karakteristika urbane. Me këtë emër për herë të parë haset në një dokument mesjetar të vitit 1439. Të dhëna të vlefshme për këtë vendbanim hasen edhe në defterin osman të shekulli XV. Sipas këtij burimi të vitit 1487, Bellobërda kishte 1,218 banorë. Përpos xehetarisë, aty zhvillohet blegtoria dhe tregtia. Si

vendbanim figuron edhe në një hartë austriake të vitit 1689. Sipas regjistrimit serb të vitit 1991, Bellobërda kishte 265 banorë, kundrejt 337 banorëve në vitin 1948. (Nazif Gashi)

BELLOPOJA Abdyl (1961-). Futbollist. Lindi në Prishtinë. Karrierën e nisi në radhët e KF “Flamurtari” të Prishtinës, ku u paraqit në brezin e parë të pionierëve, e më pas edhe të grupmoshave të reja. Pasi luajti për disa edicione në radhët e seniorëve të “Flamurtarit”, kaloi në radhët e KF “Buduqnosti” të Pejës, e më pas edhe te “Cërvena Zvezda” e Gjilanit. Pas një qëndrimi të shkurtër në KF “Prishtina”, në vitin 1990 u bë pjesë e skuadrës së njohur “Shibenik” nga Kroacia ku qëndroi dy vjet. Bellopoja ka luajtur plot tri vjet në Gjermani, kryesisht në skuadrat amatore. Pas kthimit në Kosovë, u angazhua si trajner skuadre. Është producent në redaksinë e sportit të Radiotelevizionit të Kosovës. (Baki Berisha)

BEQAJ Arian (1975-). Futbollist, trajner. Lindi në Prizren. Karrierën e portierit e nisi te skuadra e “Lirisë” së Prizrenit (1992), largohet pas tre vjetësh, shkon në Tiranë për studime universitare. Gjatë asaj kohe iu bashkua “Partizanit” të Tiranës (1995), ku luajti deri në vitin 1997 para se të kalojë në Greqi te “OFI Kreta”. Te skuadra greke qëndroi deri në vitin 2003 dhe pati 129 paraqitje kampionale. Për 12 vjet (1998-2010) ishte pjesë e kombëtares së Shqipërisë. Pas largimit nga “OFI Kreta”, kaloi te skuadra tjetër greke “Ionikos” dhe që andej, në vitin 2006, kaloi në Qipro te skuadra “Anorthosis Famagusta”. Me ekipin qipriot në edicionin e parë fitoi Kupën e Qipros, pastaj superkupën dhe titullin e kampionit (2007/08). Në vitin 2008 u shpall lojtari më i mirë shqiptar i vitit dhe me “Anorthosisin” ishte pjesëmarrës i Ligës së Kampionëve. Pas “Anorthosis-it”, karrierën e vazhdoi te “Olympiacos Nicosia” dhe “Ermis Aradioppou”. Më pas u bë trajner i portierëve te “Anorthosis Famagusta”. (Tahir Sopi)

BEQIRAJ Fatos (1988-). Futbollist. Lindi në Pejë, nisi të luajë futboll në qytetin e lindjes, në skuadrat “Shqiponja” dhe “Besë” të Pejës. Shumë shpejt iu ra në sy menaxherëve të futbollit të skuadrave të huaja, kështu që në vitin 2007 kalon te “Buduqnosti” i Podgoricës në Mali të Zi. Me këtë skuadër në edicionin 2007/08 e fiton titullin e kampionit dhe luan në finalen e Kupës së Malit

të Zi. Në edicionin e radhës, 2008/09, shpallet shënuesi më i mirë i Malit të Zi me 18 gola. Në vitin 2010 kalon në Kroaci, te “Dinamo” e Zagrebit dhe në vitin 2014 nënshkruan kontratë me skuadrën kineze “Changchu Yataj”, kurse në janar të vitit 2015 kaloi në radhët e skuadrës “Dinamo” Minsk të Bjellorusisë. F. Beqiraj për disa vjet ka mbrojtur ngjyrat e përfaqësueses së Malit të Zi. (Baki Berisha)

BEQIRAJ Jonuz (1950-). Balerin. Lindi në Zabllaq të Istogut. Shkollën e mesme të baletit e kreu në Shkup ndërsa në ansamblin e baletit të Teatrit Popullor Krahinor filloi punën më 1972. Si solist interpretoi në shfaqjet: “Filigranët”, “Sokoli dhe Mirusha”, “Ritme të zgjuara”, “Halili dhe Hajrija”, “Vallja panverore”, “Bolero dhe Shtrausi”, “Kopelia”, “Kënga e Rexhës”, “Era dhe kolona”, “Karmeni”, “Balloja e kadetëve”, “Don Kishoti”, “E bukura More” etj. Ka qenë i angazhuar edhe në dramën: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Hamleti”, “Verbimi i Samsonit” dhe “Prefekti”. Në periudhën 2002-2010 ishte mësimdhënësi i lëndës së baletit në shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova” në Prishtinë. (Selman Jusufi)

BEQIRAJ Naime (1967-). Poete, gazetar. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Prishtinë. Shkruan kryesisht poezi për të rritur dhe merret me gazetari. Ka punuar si gazetar e kulturës në disa medime. Në vitin 2009 u zgjodh anëtare e këshillit drejtues të Radiotelevizionit të Kosovës. Ka botuar veprat letrare: “Mbi Siparunt” (1990), “Maket Kosove” (2000), “Njomja e fikut” (2009). Në të tri këto vepra autorja pasqyron një realitet konkret, të cilin e mvesh me ngjyrimet poetike të një spektri të gjerë. Është përfshirë në disa antologji të poezisë shqipe dhe në gjuhë të huaja. (Nazmi Rrahmani)

BEQIRI (NALLBANI) Qemajl (1934-2016). Arkitekt, ligjërues. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për arkitekturë i kreu në Beograd (1961). Ka udhëhequr shërbimin urbanistik në kuadër të Kuvendit Komunal në Pejë deri më 1967 kur themeloi Entin për Urbanizëm dhe Arkitekturë. Në vitin 1975 për kompleksin e motelit “Trofta” në Istog mori çmimin e gazetës “Borba” dhe, pas ekspozitës në Beograd,

u prezentua në librin “Arkitektura bashkëkohore në Europën Juglindore” të profesorit Udo Kulterman nga Uashingtoni (1976). Nga viti 1984 punoi si pedagog në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitin 1997 formoi atelienë “Konsallting Biro” në Pejë. Në disa nga projektet e para aplikoi elemente nga arkitektura popullore të interpretuara në formë moderne, si në motelin “Dardania” në Pejë. Kreu edhe disa projekte të tjera, si stacioni i autobusëve në Pejë, rikonstruktimi i hotelit “Dukagjini” etj. (Dervish Qerreti).

BEQIRI Agush (1932-2006). Arkitekt i enterierit. Lindi në Pejë, ku kreu Shkollën e Mesme të Artit. U diplomua në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (dega e arkitekturës së brendshme) më 1967. Më vonë kreu specializimin në teorinë e hapësirës (1975). Dy vjet punoi në ndërmarrjen e mobileve “Napredak” të Prishtinës, ku bëri shumë projekte serike, të cilët i realizoi duke u mbështetur në krijimtarinë dhe përvojën e mjeshtërve popullorë.



AGUSH BEQIRI


Ishte autor i shumë enterierëve, në të cilët vërehet transponimi dhe vazhdimi i kësaj tradite. Me mjeshtri dhe invencion, duke përdorur materiale të teknologjisë bashkëkohore, konstrukttoi enterierë në institucione shtetërore dhe publike, si në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, në sallën e mbledhjeve të Qeverisë së Kosovës, në Hotelin “Dukagjini” në Pejë, në Hotelin “Stari Tërg” etj. Bëri edhe projekte të arkitekturës së brendshme të disa shtëpive private. A. Beqiri merrej edhe me tapiceri, të cilat i realizoi duke u mbështetur në elemente burimore, për nga motivet, ngjyrat dhe teksturën e tyre. Ato shquhen për mjeshtërinë e endësve të traditës dhe për motivet e pasura të etnografisë popullore. Hapi disa ekspozita personale me pamje dhe skica enterierësh e tapicerish dhe mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta. Për punën e tij u nderua me çmime e mirënjohje. (Blerim Luzha)

BEQIRI Albana (1973-). Gazetare. Lindi në Fier, Shqipëri. Shkollën fillore, shkollën e muzikës dhe gjimnazin i mbaroi në vendlindje,

kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Tiranës. Punën në gazetari e nisi në gazetën “Zëri i rinisë” në Tiranë më 1991, ndërsa nga viti 1995 vazhdoi në “Rilindjen” e Prishtinës (botim i Tiranës), kurse më vonë ushtroi detyrën e redaktorit në gazetën “Tribuna demokratike” po në Tiranë. Ishte korrespondente nga Tirana e gazetës “Bota sot”, botim në Zvicër, korrespondente e “Zërit të ditës” në Zyrrih dhe më pas gazetarë e së përditshme “Zëri” në Prishtinë. Në periudhën janar-dhjetor 2013 ishte autore dhe kryeredaktore e 48 dokumentarëve televizivë të ciklit “Gratë dhe drejtësia”, autore dhe skenariste e dokumentarit televiziv “Fundi i heshtjes”, me temë gratë e dhunuara në luftë. Bashkëpunoi me periodikët në Tiranë dhe në Prishtinë. Për disa vjet ndoqi zhvillimet kulturore në Prishtinë me lajme, komente, kritika mbi teatrin, muzikën, filmin, artin pamor, librin etj. Është redaktore e kulturës në Radiotelevizionin e Kosovës. (Zenun Çelaj)

BEQIRI Aqif (1928-1984). Ekonomist. Lindi në Ferizaj, ku mbaroi shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme ekonomike e kreu në Pejë (1955). Kreu studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Sarajevës (1963). Një kohë punoi në administratën e fabrikës së duhanit në Prizren. Më 1972 emërohet drejtor i përgjithshëm i kombinatit bujqësor-industrial “Progres-Export” në Prizren. Ishte themelues dhe drejtor i përgjithshëm i Agrokombinatit bujqësor-industrial “Agrokosova”, në kuadër të të cilit u integruan të gjitha kombinatet bujqësore dhe kooperativat bujqësore të Kosovës. Ai krijoi dhe vuri në funksion mekanizmin e bashkëpunimit me kooperativat bujqësore, me prodhuesit privatë bujqësorë dhe zgjeroi tregun për plasman të prodhimeve brenda dhe jashtë vendit. Dha kontribut si organizator, menaxher dhe ekonomist me përvojë dhe me vizion të qartë zhvillimor. Kreu edhe funksione të tjera të rëndësishme në asociacionet ekonomike dhe në institucionet shtetërore të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. (Bashkim Kabashi)

BEQIRI Ekrem (1944-2008). Inxhinier i teknologjisë, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë, studimet i kreu në Fakultetin e Teknologjisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Beogradit (1968).



EKREM BEQIRI

Në Universitetin e Beogradit kreu edhe studimet dhe mbrojti tezën e doktoratës (1982). Fillimisht punoi në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë dhe në Shkollën e Lartë Ekonomike-Komerciale në Pejë (1968). Që nga viti 1972 u angazhua në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë, ku në vitin 1983 merr titullin e docentit për lëndën operacionet teknologjike. Bëri specializime në Poloni, Itali dhe SHBA. Në vitin 1988 merr titullin profesor inordinar dhe më 1999 profesor ordinar. Është autor dhe bashkautor i disa teksteve universitare: “Operacionet difuze” (1986), “Operacionet teknologjike” (1996) etj. dhe i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale të publikuara në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ishte autor i logos së parë të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës dhe i logos së Trupave Mbrojtëse të Kosovës. (Avni Terziqi).

BEQIRI Fahri (1936-). Kompozitor, mësimdhënës i muzikës. Lindi në Mitrovicë. Pas Shkollës së Mesme të Muzikës në Prizren, studioi në drejtimin e kompozimit në Akademinë e Muzikës në Beograd, ku u diplomua më 1970, në klasën e prof. Josif Enriko. Ishte pedagog në disa shkolla fillore, gjimnaze, normale dhe shkolla të muzikës. Më pas profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Akademinë e Arteve në Prishtinë, ku ligjëroi lëndët polifoni dhe harmoni. Përpos aktivitetit krijues ishte edhe udhëheqës e organizator profesional muzikor në shumë shoqëri kulturore-artistike, i orkestrave popullore, argëtuese, të mandolinave, orkestrinave frymore dhe koreve të ndryshme. Ishte drejtor i Ansambllit të këngëve e valleve “Shota” (1967), bashkëthemelues, sekretar dhe kryetar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, kryeredaktor muzikor në Radiotelevizionin e Prishtinës etj. Krijimtaria e tij përfshin vepra dhe përpunime korale, si për të rritur ashtu dhe për fëmijë. Ndër to dallohen: “Erdh



FAHRI BEQIRI

msiti”, “Madrigali i Ibrit plak”, “Moj e mira”, sidomos “Këndej kaloi armiku”, të gjitha për kor të përzier, si dhe një varg të tjerash për kor pionierësh. Gjithashtu ka kompozuar në frymën popullore, të muzikës së lehtë dhe një varg vallesh orkestrale. Ndërkaq, veçohen veprat solistike-instrumentale: “Suita për piano”, “Skerco për piano” dhe “Sonatën për klarinetë e piano”. Nga gjinia e veprave kamerale: “Kuineti frymor”, ndërsa nga ato simfonike poema simfonike “Skënderbeu”. Ka kompozuar dhe muzikë filmi dhe teatri: “Të ngjuarit” (1970), “Trungu ilir” (1981), si dhe tablo baleti “Paralojë dasme” (1975). Është laureat i disa çmimeve, ndër të cilët edhe i Çmimit kombëtar për vepër jetësore “Niketë Dardani”, si dhe i mirënjohjeve të tjera në festivale dhe manifestime muzikore. (Sami Piraj)

BEQIRI Galip (1952-). Vepërtar politik, mësimdhënës. Lindi në fshatin Tërrnoc i Madh. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet universitare për sociologji i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2002, kur shqiptarët e Luginës së Preshevës morën funksionet themelore në qeverisjen komunale, G. Beqiri u emërua drejtor në Bibliotekën Komunale, ku qëndroi deri në vitin 2012. Ishte kryetari i parë i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi. Kryetar i këtij Këshilli u zgjodh në seancën e parë konstitutive të mbajtur më 3 korrik 2010. Është zyrtar i Partisë për Veprim Demokratik. (Qerim Qerimi)

BEQIRI Ilirjan (1968-). Pikturor. Lindi në Tetovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Në vitin 1998 u diplomua në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Në vitet 2006-2007 ishte ministër i Kulturës në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Nga viti 1998 është pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. I. Beqiri në pikturat e tij u përqendrua në trajtimin e peizazhit të mjedisit ku jeton. Hapi ekspozita personale dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive. Në mesin e tyre më të rëndësishme janë ekspozitat e realizuara në Prishtinë, Shkup, Tetovë, Paris, Nju-Jork. (Jëldeze Asani)

BEQIRI Mon (1953-). Gazetar. Lindi në Bajgorë të Mitrovicës. Pas shkollimit fillor dhe të mesëm në vendlindje, mbaroi studimet në

Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1980). Punën e gazetarit e filloi që më 1976 në gazetën e kolektivit “Trepça” të Mitrovicës, pastaj u bë korrespondent i Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP) nga Mitrovica. Ishte edhe redaktor për çështje ekonomike në RTP. Nga viti 2000 është producent dhe redaktor i emisionit “Zëri ynë” në Radiotelevizionin e Kosovës, në të cilin transmetohen raporte dhe emisione dokumentare për mërgatën shqiptare. Ka botuar vjersha për fëmijë dhe të rritur. (Shaqir Foniqi)

BEQIRI Nehat (1967-). Pikturor. Lindi në Tetovë. Kreu shkollimi fillor dhe të mesëm në vendlindje. U diplomua në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punon si pedagog i lëndës së pikturës në Universitetin e Tetovës. Është anëtarë i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë dhe i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Tetovës. Është pikturor avangard, i cili punoi edhe në skulpturë dhe dizajn. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive dhe hapi disa ekspozita individuale. Mori çmime me rastin e ekspozitave dhe në evenimente figurative, si çmimin e parë për bustin e Naim Frashërit në Tetovë, çmimin e parë për bustin e Nënë Terezës në konkursin e organizuar nga Fondacioni kulturor “Nënë Tereza” dhe Galeria e Arteve të Kosovës, pastaj çmimin për skulpturën e Pjetër Bogdanit në projektin “Shkupi 2014”. Është për t’u veçuar ekspozita e tij e mëvetësishme e realizuar në Qendrën Informative-Kulturorë në Shkup. (Jëldeze Asani)

BEQIRI Rrahim (1957-2001). Vepërtar, dëshmor i luftës në Maqedoni. Lindi në fshatin Kopernicë të Kamenicës. Kreu shkollën e mesme në Kamenicë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Për shkak të aktivitetit politik u keqtrajtua dhe u burgos disa herë. Në vitet ’90 emigroi në Gjermani. Me fillimin e luftës në Kosovë, u bashkohet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në zonën e Marecit. Mori pjesë në shumë beteja. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në fillim të vitit 2000 u burgos nga forcat ruse. Pas lirimimit nga burgu, iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, ndërsa më 2001 iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Më 21 korrik 2001, duke luftuar kundër forcave maqedonase u

plagos rëndë dhe më pas, më 1 gusht 2001 vdiq nga plagët e marra. Në Kamenicë i është ngritur përmendorja në shenjë nderimi për veprën e tij. (Fehari Ramadani)

BEQIRI Sokol (1964-). Grafist. Lindi në Pejë. Kreu Fakultetin e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës, në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare për grafikë në Fakultetin e Arteve



SOKOL BEQIRI

të Universitetit të Lubjanës. Hapi ekspozita personale me tematikë instalacionesh në Galerinë “Ars” në Lubjanë (1991), në Qendrën për Kulturë Lindje-Perëndim në “Pallatin Jalta” në Frankfurt (1994), në Qendrën për Kulturë “Ignis” në Këln (1995), në Galerinë “InterMedia” në Prishtinë (1995), në “GTZ” Echborn (1995) etj. Me grafika, videoart, performanca dhe instalacione mori pjesë në shumë manifestime të tilla dhe në shumë paraqitje kolektive, bienale grafike dhe sallone arti në Kosovë, Mal të Zi, Turqi, Spanjë, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Greqi, Francë, Gjermani, Britani të Madhe etj. Më 2014 në Galerinë e Arteve të Kosovës u mbajt ekspozita retrospektive e punës së tij njëzvetëçare. (Basri Mekolli)

BEQIRI Shaip (1954-). Poet. Lindi në Gllamnik të komunës së Podujevës. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku më



SHAIP BEQIRI

pas vazhdoi edhe studimet pasuniversitare. Një kohë të shkurtër ishte mësimdhënës në gjimnazin e Podujevës, pastaj redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën e studentëve “Bota e re”, për të vazhduar deri në vitin 1993 si gazetar dhe redaktor i rubrikës së kulturës në revistën “Zëri i rinisë”. Ishte edhe anëtar i redaksisë së të përkohshmes për kulturë, art e letërsi “Fjala”, ndërsa në vitet 1993-1994 bënte pjesë në redaksinë e të përjavshmes politike “Forumi”. Është autor i këtyre veprave me poezi: “Fontana e etjeve” (1976, botim i dytë i plotësuar më 2006), “Eklipis i gjakut” (2000),

“Prangat e praruara: 99 poezi dhe një ankt” (1998), “Flatrat e gjymta” (1983), “Rekuiem për veten” (1997), “Hidra e mllefrit” (poezi në gjuhën shqipe e gjermane, 2014). Botoi edhe librin me vështrime kritike “Sfida e gjenit: Kadare, ekzili, Kosova”. Poezitë e tij janë përkthyer në gjuhë të huaja dhe janë përfshirë në disa antologji. Është anëtar i Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë të Zvicrës, ku së voni është zgjedhur kryetar i saj. Jeton dhe vepron në Zvicër. (Adil Olluri)

BEQIRI Valton (1967-). Pianist, kompozitor. U diplomua në degën e pianos dhe në atë të kompozimit në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës (prof. R. Rudi).



VALTON BEQIRI

Gjatë studimeve dhe më pas u prezantua si pianist e kompozitor në festivale në Kosovë, Shqipëri, ish-Jugosllavi dhe më gjerë. Veprat e tij mbështeten në tiparet neoklasike me tingëllimë të freskët dhe ritmikë të ndërlidhur popullore. Ndër veprat e rëndësishme veçohen: “Poema e heshtjes” për kor të përzier; Variacione për trio frymor; Kuarteti harkor (botuar në Itali); Variacione për flaut, klarinet e piano; Konçertino për piano e orkestër etj. Në edicionin II të Festivalit Ndërkombëtar “Skena e Re Muzikore e Prishtinës”, 2003, u realizuan me sukses veprat “744S” për kuartet saksofonësh dhe folk dance për dy saksofonë e piano (premierë), interpretuar nga Ansambli suedez “Stockholms Saxofonkvartet”. Në edicionin IV të këtij festivali me emërtim të ri “Re-Musica” (2005) u interpretuan veprat: “Albanica”, koncert për saksofon, orkestër harqesh e perkusione (me këtë vepër u magjistrua në degën e kompozimit) dhe variacione për trioharkorë. Përveç punës krijuese shquhet dhe si pianist me përvojë të pasur koncertale, solist e korepetitor i suksesshëm. Nga viti 1990 ligjëron në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Sami Piraj)

BEQIRI Xhavit (1971-). Poet, studiues i letërsisë. Lindi në Koliq, komuna e Prishtinës. Kreu shkollimin e mesëm dhe studimet e gjuhës në Prishtinë. U doktorua më 2014 me temë për veçoritë gjuhësore dhe stilistike të “Lahutës së

Malcis” të Gjergj Fishtës. Më 2003 është zgjedhur asistent në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, ku tash është ligjërues. Më herët ka punuar si gazetar në gazetën “Bota sot”, “Dardania”, “Kosova sot” dhe “Pavarësia”. Ka qenë redaktor i revistës për kulturë, art e letërsi “Fjala”. Në fushën e studimeve letrare dhe të kritikës ka botuar veprat “Liria e leximit” (2000), “Gjuha dhe letrat” (2005), “Gjuha dhe stili i Martin Camajt” (2007), “Identiteti gjuhësor dhe globalizmi”, (2012) etj. Në krijimtarinë poetike ka botuar përmbledhjet “Lutje për njeriun” (1994), “Magjia e shtangies (1997), “Shën Vjeshta” (2002), “Cogito” (2015). Poezia e tij flet për individin në sprovë me jetën e përditshme, përdor gjuhë të pasur dhe dëshmon individualitet poetik. (Zejnullah Rrahmani)

BERANI Evliana (1961-). Gazetare. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollimin bazë dhe Fakultetin Juridik. Kreu studimet pasuniversitare dhe specializoi në fushën e politikave dhe të legjislacionit në Gjermani dhe Britani të Madhe. Filloi të punojë si gazetarë në gazetën “Rilindja” që në vitet ’80, ku ndoqi zhvillimet politike dhe shoqërore nga fusha të ndryshme. Në vitet ’90 ishte njëra nga themelueset e programit në gjuhën shqipe të Radios “Europa e lirë” në Pragë. Gjatë luftës në Kosovë ishte korrespondente dhe producente për gazeta dhe televizionin prestigjioze (“Nju-Jork Times”, BBC etj.). Punoi në realizimin e emisioneve të ndryshme dokumentare për zhvillimet që u paraprinë bombardimeve të NATO-s, për masakrën e Reçakut, për eksodin etj. Pas luftës një kohë ishte redaktore përgjegjëse në Televizionin Publik të Kosovës. Ishte pjesë e Misionit të OKB në Timorin Lindor, pastaj punoi në Kazakistan, Sllovaki, Shqipëri, Moldavi, Kirgistan, Mali i Zi etj. (Ibrahim Berisha)

BERANI Fazli (Metë) (1875-1954). Pleqnar dhe luftëtar i lëvizjes çlirimtare. Lindi në Klinë të Epërme të Skënderajt. Që në rini iu bashkua çetave kryengritëse dhe mori pjesë në kryengritjet kundër Perandorisë Osmane më 1908-1912. Me okupimin e Kosovës nga Serbia, u zu rob lufte, u dërgua në kampin e Runikut, nga i cili u arratis, por mbeti në mal dhe vazhdoi luftën edhe gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitet 1915-1917 ishte bashkëluftëtar i Shaqir Smakës. Më pas i bashkëngjitet çetës së Azem

Bejtës. Pas vrasjes së Azem Bejtës (1924), kalon në Shqipëri dhe vendoset në fshatin Derven të Fushë-Krujës. Më 1941 kthehet në vendlindje, merret me bujqësi dhe me pajtimin e gjaqeve dhe të ngatërresave. Gjatë Luftës së Dytë Botërore simpatizonte forcat antifashiste. (Liman Rushiti).

BERANI Idriz (1943-1996). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Klinë të Epërme, komuna e Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme për ekonomi në Ferizaj (1963), ndërsa studimet e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP), ku i mbaroi edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1984). Për qëllime studimore qëndroi në Universitetin “Lomonosov” të Moskës (1978/79). Punën arsimore-pedagogjike e filloi si mësimdhënës i matematikës në Skënderaj, pastaj zgjidhet asistent në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe në FSHMN të UP-së i merr të gjithë titujt universitarë. I. Berani mbajti ushtrime dhe ligjërata nga lëndët gjeometria analitike, gjeometria diferenciale, analiza matematike etj. Interesimi i tij shkencor i takon fushës së gjeometrisë diferenciale. Botoi disa punime shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare dhe tekstin universitar “Gjeometria analitike”. Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore të matematikanëve dhe fizikanëve. (Qamil Haxhibeqiri)

BERANI Shaqir (1933-2013). Albanolog, mësimdhënës dhe punonjës shkencor. Lindi në fshatin Derven të Krujës, në një familje nga Klina e Epërme, Skënderaj. Shkollën fillore e kreu në Skënderaj, gjimnazin e ulët në Prizren, normalen në Prishtinë. Studioi gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi e doktoroi. Ka punuar si mësimdhënës, pastaj edhe drejtor në shkollë fillore të Skënderajt. Pak kohë ishte përkthyes në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës. Prej vitit 1974 ishte bashkëpunëtor i jashtëm i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, ndërsa prej vitit 1976 kaloi me punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku kishte edhe disa funksione drejtuese. Fushë e interesimit të tij shkencor ishin çështje të ndryshme gjuhësore, në veçanti gjuha standarde dhe norma letrare. Botoi disa vepra: “Çështje të normës letrare”, “Gjuha e

Josif Bagerit” (1988), “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj” (1989) etj. (Naser Zabeli)

BERISHA - “ABEJA” Bekim (1966-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Graboc të Pejës. Kreu studimet për hotelieri në Opati, ndërsa



BEKIM BERISHA - “ABEJA”

Fakultetin e Veterinarisë në Zagreb. Ishte pjesë e legjionit francez, që luftoi terrorizmin, për çka mori mirënjohje edhe nga SHBA-ja. Me shpërthimin e luftës në Kroaci, u kthye nga Holanda, për t’u radhitur në mesin e luftëtarëve

çlirimtarë të Kroacisë e më pas edhe të Bosnjës. Ishte pjesëtar i Gardës Kombëtare të Kroacisë. Në radhët e bashkëluftëtarëve në Kroaci njihet me emrin e luftës “Shok”. Në fillim të marsit 1998, B. Berisha, i njohur me emrin e luftës “Abeja”, me një grup mërgimtarësh hyn në Kosovë për t’u bërë pjesë e UÇK-së. U sistemua në AçaREVË të Drenicës, ku filloi stërvitjet me ushtarët e rinj. Në prill të vitit 1998 po në AçaREVË hapi Akademinë Ushtarake të UÇK-së. Po ashtu hartoi strategjinë luftarake dhe udhëhoqi një varg betejash në Drenicë. Në qershor të vitit 1998 mori pjesë në betejën për marrjen nën kontroll të minierës së Bardhit të Madh. Më 2 korrik, në krye të një grupi prej më se 600 vullnetarësh u nisën nga Drenica për në Shqipëri për furnizim me armatim. Më 27 korrik u kthye në Kosovë, në krye të më shumë se 400 luftëtarëve. Për dy javë luftoi në rajonin e Jasiqit, të Junikut dhe të fshatrave të tjera të Rekës. Ra heroikisht në betejën e Junikut më 10 gusht 1998, i goditur nga një predhë tanku e artilerisë serbe. Me rastin e rënies heroike të gjeneralit Bekim Berisha, Parlamenti i Kroacisë shpalli ditë zie në Kroaci. Për merita të jashtëzakonshme u dekorua nga presidentët e tri shteteve: presidenti i Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës” (2010); presidenti i Kroacisë e nderoi me dekoratën e lartë ushtarake “Kryqi i Kuq Kroat” (2013) dhe presidenti i Shqipërisë e ndau dekoratën “Nderi i Kombit” (2015). (Fetnete Ramosaj)

BERISHA Ahmet (1940-2011). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Pozhar të Deçanit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të

mesmen e përfundoi në Pejë. Studimet për biologji i kreu në Prishtinë (1967), studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (1983). Një kohë punoi në gjimnazin e Deçanit, më pastaj pranohet asistent në departamentin e biologjisë të FSHMN-së (1975), ku punoi deri në pensionim, duke arritur të gjitha gradat universitare. Publikoi disa punime shkencore në botime profesionale dhe është autor tekstesh për shkolla të mesme. Realizoi vizita studimore në laboratorë dhe institute të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, përfshirë edhe Institutin Embriofiziologjisë në Akademinë e Shkencave Ruse në Moskë. (Fetah Halili)

BERISHA Ajvaz (1961-). Mësimdhënës universitar. Lindi në fshatin Vasilevë të komunës së Drenasit, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërkaq u diplomua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës i gjimnazit në Drenas deri në vitin 1992, kur emigroi në Gjermani. Atje vazhdoi të merrej me sportin e karatesë, ndërkohë më 1994 mori titullin e instruktorit. Me fillimin e luftës së Kosovës iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte udhëheqës i njësisë speciale “Tigrat”. Në vitin 2002 mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës, ndërsa një vit më vonë u bë ligjërues në këtë fakultet. Në vitin 2005 mori titullin doktor i shkencave sportive. Disa vjet punoi në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë të Kosovës. Ndërkohë ligjëroi lëndën e sporteve luftarake. Ka shiritin e zi 5 DAN. Dy herë ishte dekan Fakultetit të Shkencave Sportive. (Besim Kajtazi)

BERISHA Anton Nikë (1946-). Studiuës, shkrimtar. Lindi në Dobërdol të Klinës. Mbaroi Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit dhe u doktorua në shkencat e filologjisë. Ka realizuar disa qëndrime studimore jashtë vendit.



ANTON NIKË BERISHA

Në Institutin Albanologjik të Prishtinës punoi nga viti 1973, duke arritur së fundi titullin këshilltar shkencor. Në vitin akademik 1992/93 mbajti mësim në katedrën e albanologjisë të Universitetit Muniht. Nga nëntori i vitit 1993 punoi në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë të Universitetit të Kalabrisë. Në fushën e letërsisë së pari botoi poezi për fëmijë, “Kthimi i Skënderbeut në Krujë” (1970), duke vazhduar me vepra me ese dhe studime letrare: “Përki-me poetike” (1978) dhe “Mundësi inerpretimi” (1979). Fushë e interesimit të tij është letërsia popullore, letërsia për fëmijë dhe, viteve të fundit, studimi i letërsisë arbëreshe. Botoi një varg veprash me studime letrare dhe monografi për De Radën, Gj. Fishtë, Z. Skiroin, E. Koliqin, M. Camajn, M. Krasniqin, D. Vetmon, A. Shkrelin, pastaj romane për të rritur e për fëmijë, vëllime me materiale të letërsisë gojore, punime në revista të ndryshme në shqip dhe në gjuhë të tjera. Nga gjermanishtja përktheu “Epin e Gilgameshit” (1984) dhe këngën e parë dhe të pestë të “Këngës së Nibelungëve”, ndërsa nga italishtja përktheu poemën e Domeniko Korradinit H. Brusard “Lavdërimi i kryqëzuar” (2007). Është nderuar me çmime të ndryshme letrare brenda dhe jashtë vendit. Disa vepra të tij janë botuar në gjuhën italiane. (Sali Bashota)

BERISHA Arben (1980-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe dhe gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Me gazetari sportive filloi të merret në vitin 2001, në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), si gazetar dhe komentator i ngjarjeve sportive. Krahas punës si komentator drejton edhe emisionet e përditshme, javore dhe periodike të sportit. Ka bërë mbi 850 transmetime të drejtpërdrejta nga ngjarje të ndryshme sportive vendore e ndërkombëtare, përfshirë katër kampionate botërore të futbollit, tri kampionate europiane të futbollit, gjashtë olimpiada (tri verore e tri dimërore), gjashtë finale të ligës së kampionëve, pastaj shumë kampionate vendore të futbollit e basketbollit, si dhe ngjarje të tjera vendore e ndërkombëtare. (Florim Maliqaj)

BERISHA Arian (1974-2015). Pikturor. Lindi në Therandë. Kreu shkollën e mesme në Prishtinë, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Arteve,

dega e pikturës, po ashtu në Prishtinë (1999). Ekspozoi në Prishtinë, në Galerinë “Dodona” (1999), te “Hani i 2 Robertëve” (2001), në Galerinë e Departamentit të Kulturës (2002) dhe më 2004 në Galerinë e Arteve të Kosovës. Mori pjesë në disa ekspozita kolektive: më 1998 në Grac të Austrisë, më 1999 në manifestimin “Flaka e Janarit” në Gjilan, më 1999 në ekspozitën tematike “Golgota shqiptare” në Galerinë e Arteve të Kosovës (2000), me ushtarët e KFOR-it sërish në Galerinë e Arteve të Kosovës (GAK), në ekspozitën “Kosova dhe Shqipëria” (2002), pastaj po në këtë Galeri në ekspozitën tjetër tematike “Dita e Prishtinës” (2002), në Muzeun e Kosovës dhe në Tokio e në Strasburg më 2003. Mori çmimin e parë në Bienalen XI të vizatimit (2000), çmimin e parë për pikturë në manifestimin “Flaka e Janarit” në Gjilan (2002) dhe në “Dita e Prishtinës” në GAK (2002). (Rexhep Ferri)

BERISHA Bajar (1950-). Dirigjent. Lindi në Prishtinë, mbaroi Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës. Kreu Fakultetin e Muzikës, drejtimi i dirigjimi në Beograd, studimet pasuniversitare në Sarajevë, ndërsa u specializua në Hochschule der Kunst, Berlin (1982). Pedagog në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, më pas docent, kurse tash profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Udhëheqës artistik-dirigjent i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP), dirigjoi edhe me Filarmoninë e Beogradit, me Orkestrën simfonike të APJ-së, me Orkestrën Simfonike të Nishit, me Filarmoninë e Kosovës, me Orkestrën simfonike dhe me Korin Profesional të RTP-së, me Orkestrën e Mostarit, Orkestrën simfonike të Teatrit Kombëtar Kroat të Zagrebit, Orkestrën “Camerata” të Prishtinës, Orkestrën dhe Korin e Fakultetit të Arteve. Veçohet koncerti me Orkestrën Simfonike të RTP-së në “Lojërat Verore” të Dubrovnikut (1981). Dallohet me interpretime kreative të veprave të autorëve tanë: F. Beqiri (Poema simfonike “Skënderbeu”), E. Rizvanolli (Musica sinfonica etj.), Z. Ballata (Suitë për orkestër harqesh, “Passacaglia”), R. Rudi (Simfonia në dy blloqe), R. Dhomi (opera “Dasma arbëreshe”), W. A. Mozart (opera komike-Singspiel “Bastien und Bastenne”). Është autor i “Fjalor enciklopedik muzikor-terminologjik” (2014). (Sami Piraj)

BERISHA Bajram (1962-). Veteriner, fiziolog, profesor universiteti. Lindi në Suharekë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Universitetin e Prishtinës (UP), në



BAJRAM BERISHA

Fakultetin e Bujqësisë (1986), magjistroi në Universitetin e Lubjanës, ndërsa tezën e doktoratës dhe habilitimin (2007) në Universitetin Teknik të Munihut, në Gjermani. Në vitin 1986 zgjidhet asistent në Fakultetin e Bujqësisë të

UP-së, ndërsa një vit më vonë edhe në Fakultetin e Shkencave Biologjike të Universitetin Teknik të Munihut. Pas habilitimit u zgjodh profesor i asociuar po në këto dy fakultete dhe më pas profesor ordinar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe në Universitetin e Prishtinës (2012). Realizoi disa projekte shkencore në Universitetin Teknik të Munihut dhe në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë. Është autor i punimeve shkencore të botuara në revista të ndryshme, përfshirë botimin e shumë sekuençave të reja gjenesh që janë publikuar në SHBA. Është autor i dy librave shkencorë, botuar në Gjermani: “Faktorët angjiogjenikë në vezoren bovine” (Munih, 2001) dhe “Rregullimi lokal në vezoren bovine - Degradimi i matriksit jashtëqelizor, angjiogjeneza dhe angjioliza” (Gëtingen, 2007). Fushat e veprimtarisë së tij shkencore janë fiziologjia, gjenetika dhe bioteknologjia animale. Në Kosovë kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës. Ka qenë koordinator i projektit “Tempus”, i cili mbështet programin për studime të doktoratës në shkencat e ushqimit dhe të teknologjisë. (Latif Susuri)

BERISHA Baki (1961-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku e kreu shkollimin bazë dhe studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punën e gazetarit e fillon në të përditshmen “Bujku”, kurse në dhjetor të vitit 1999 kaloi në gazetën ditore “Zëri”, ku qëndroi për 15 vjet, deri në fund të vitit 2014. Ndoqi shumë ngjarje sportive në vend dhe në botën e jashtme. Për punën e suksesshme në gazetari mori çmime dhe mirënjohje. (Florim Maliqaj)

BERISHA Beqir (1955-). Boksier, trajner. Lindi në Prishtinë. Karrierën e filloi në vitin 1974 në

KB “Prishtina”. Në veprimtarinë e tij 10-vjeçare B. Berisha arriti t’i fitojë dy tituj të kampionit të ish-Jugosllavisë me KB “Prishtina”, ndërsa ishte pjesëmarrës në shumë gara ndërkombëtare. Ishte edhe anëtar standard i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë, ndërsa shumicën e meçeve i zhvilloi në kategorinë e mesme. Ka zhvilluar rreth 190 meçe, prej të cilave rreth 90 për qind i ka fituar. Berisha për një kohë ka qenë edhe trajner i KB “Prishtina”. (Bekim Aliu)

BERISHA Besart (1985-). Futbollist. Lindi në Prishtinë. Si fëmijë migroi me familje në Gjermani, kurse karrierën e nisi si nëntëvjeçar te skuadra “Berliner VB 49” (1994), pastaj nëpër disa skuadra të rangjeve të ulëta. Te “Tennis Borussia Berlin” u shpall shënuesi më i mirë në ligën e të rinjve. Një vit më vonë (2004) kaloi në Bundesligë, te skuadra e “Hamburgut”. Dy edicione u huazua te skuadra “Aalborg” dhe “Horsens”, më vonë u kthye sërish te “Hamburgu” (2006/07) dhe debutoi në Bundesligë. Në vitin 2007 kaloi te skuadra angleze “Burnley” për t’u huazuar sërish te skuadrat “Rosenborg” e “Horsens”. Në vitin 2011, derisa ishte pjesë e “Arminia Bielefeld-it”, vendosi të kalojë në Ligën A të Australisë, te skuadra “Brisbane Roar”. Në edicionin e tij të parë në Australi, fitoi epitelin e shënuesit më të mirë. Është pjesë e skuadrës tjetër australiane “Melbourne Victory” (2014). Në kombëtaren e Shqipërisë pati 17 paraqitje (2006-2010). Nga viti 2016, pasi mori pëlqimin nga FIFA, është pjesë e kombëtares së Kosovës. (Tahir Sopi)

BERISHA Budim (1943-2013). Piktur. Lindi në Prizren, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Studioi për pikturë në Akademinë e Arteve



BUDIM BERISHA

Figurative në Beograd, ku u magjistrua në vitin 1976. Përveç me pikturë, u mor edhe me teorinë e artit dhe me shkrime letrare. Nga shkrimet e tij veçohet monografia “Hieroglifet kosovare”, me të cilën synoi të sintetizonte artin vizual

me atë poetik. Në etapat e tij krijuese shquhet faza kur u përfshi në botën e simboleve për të krijuar një model të ri në pikturë. Në këtë periudhë realizoi një cikël punimesh, duke përdorur materiale dhe teknika ndër më të

ndryshmet. B. Berisha nisi të ekspozonte që herët, së pari në Prizren (Hamami i Vjetër, 1966), pastaj në Gjakovë, në Beograd, Rahovec dhe në Prishtinë (Galeria Kombëtare e Arteve, 2011). Mori pjesë dhe në ekspozitat e përbashkëta të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës, pastaj në Sallonet Pranverore, në ekspozitat vjeshtore dhe në Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit, ku u shpërblye në vitin 1978. Ishte fitues i disa mirënjohjeve dhe i çmimeve profesionale. (Tahir Emra)

BERISHA Burbuqe (1970-). Regjisore, producente. Lindi në Shkup, kurse shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë. Studimet për regji filmi i kreu në Fakultetin e




BURBUQE BERISHA

Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është autore e filmave dokumentarë, të metrazhit të shkurtër dhe e filmave televizivë. Bëri regji edhe në teatër. Punoi si menaxhere në Kino ABC, producente në “Kosovafilm” dhe ishte drejtore në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Është në produksionin “Zero pozitiv”. Disa nga realizimet e saj janë: “Lexi në qytet” në dhjetë episode, “Ashensori”, “Suxhuk open”, “Kosova 9/11”, “Ëndrra”, “Nanë”, “Dimni i shpirtit”, “Bunari”, “Viti 2000”, “Diçka po zihet”, “Gratë”, “Çelësi”. Nga filmat e saj dokumentarë shquhen “Për Jusuf Gërvallën”, “Universiteti nëpër vite”, “Harmonika”, “Të rritur në rrugë”, “Kinematë” etj. Ka bërë disa shfaqje teatrore, prej të cilave veçohen: “Një çaj me Hillaryn”, “Revolveri” “Darka Private” etj. (Gani Mehmetaj)

BERISHA Dardan (1988-). Basketbollist. Lindi në Pejë. Nisi karrierën në KB “Peja”, ndërsa e vazhdoi në Zagreb. Një edicion luajti në Spanjë, si anëtar i skuadrës “Cibonie Caceres”. Në periudhën 2007-2010 ishte lojtar i skuadrës polake “Varshava”, ndërsa në vitin 2010 kaloi në radhët e skuadrës “Anwil Wloclawek”. Me fanellën e përfaqësueses së Polonisë debutoi më 2 gusht 2010, në ndeshjen kundër Gjeorgjisë. Në vitin 2011 luajti në Kampionatin European si anëtar i përfaqësueses së Polonisë, me mesatare prej 13.2 pikësh në 5 ndeshje. Në vitin 2012 kthehet në Kosovë për t’i mbrojtur ngjyrat

e “Pejës”, ndërsa një vit më pas kalon në “Sigal Prishtina”, skuadër me të cilën në edicionin 2014-2015 fiton titullin e kampionit në Ligën Ballkanike, duke u zgjedhur edhe lojtari më i mirë i kësaj lige ndërkombëtare. (Bekim Aliu)

BERISHA Daut (1941-). Piktur. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë. U diplomua në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu



DAUT BERISHA

në Akademinë e Arteve të Bukura në Paris. Nga viti 1973 mori pjesë në ekspozita të përbashkëta me piktorët francezë, sidomos në “Grande Palais” dhe në Galerinë “Iris Clert” të Parisit. Ekspozoi në Paris (1977, 1979), Mont la Jolie (1979), Nansye (1982), Vale de Bravo, Meksikë (1982) dhe Los Anxhelos (SHBA). Botën reale dhe joreale të njeriut D. Berisha në pikturat e tij e ktheu në formësim artistik, herë si dritë fizike dhe herë si rrëfim shpirtëror. Në fillim artin e tij e përcolli simbolika e trajtave dhe më vonë pasuria e ngjyrave. Veprat e tij gjenden në shumë koleksione private, galeri e muze. Jeton dhe vepron në Paris. (Rexhep Goçi)

BERISHA Engjëll (1926-2010). Piktur. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike (dega e artit figurativ) në Beograd më 1954. Në fillim punoi si arsimtar i vizatimit në shkollat tetëvjeçare në Gurakoc e Prapaçan (1948-1958), si dhe në Shkollën Normale të Prishtinës (1958-1977). Më pas punoi në Entin Krahinor për Mbrojtjen e Përmendoreve të Kulturës (1978), ndërsa më ishte vonë ishte bashkëpunëtor profesional në Galerinë e Arteve në Prishtinë derisa u pensionua (1987). Piktura e tij është e frymëzuar nga tradita historike e popullit (“Idhulli”, “Koka e Neolitit” etj.), parasimbolika, harmonia, besimi në Tokën, Diellin dhe Dritën. Veprat e tij mbështeten në krijimtarinë popullore, por të transponuar në mënyrë simbolike, me një botëkuptim bashkëkohor figurativ. Karakteristikë e kësaj pikturë është statika, simetria, figura e paraqitur në enfas apo objekti në formë frontale. Me gjuhën e tij individuale realizoi disa cikle që shquhen për nga origjinaliteti, si: “Femra kosovare”, “Kulla e përqufuar”, “Medaljonet e Prizrenit” etj. Ishte



PIKTURË E ENGJËLL BERISHËS

laureat i disa çmimeve dhe i mirënjohjeve brenda dhe jashtë vendit. (Mirënjohje nga Galeria e Tuzllës më 1971 dhe nga Salloni Dimëror i Hercegnovit më 1977, pastaj çmimin e Sallonit Pranveror të Kosovës më 1974 etj.). Realizoi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta, në të cilat u prezentua arti bashkëkohor i Kosovës. (Blerim Luzha)

BERISHA Engjëll (1934-2015). Muzikolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Prizren. I përket brezit të parë të maturantëve të Shkollës së Muzikës në Prizren (1949-1953).



ENGJËLL BERISHA

Ndoqi studimet në seksionin teorik-pedagogjik në Akademinë e Muzikës në Beograd. Kreu studimet pasuniversitare të muzikologjisë në Akademinë e Muzikës në Sarajevë më 1981 dhe u magjistrua me “Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës” (botuar më 1997). Dhjetë vjet ligjëroi historinë e muzikës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren (1958-1968), një kohë ishte drejtues i koreve të shkollës dhe Shoqërisë kulturore-artistike “Agimi”. Gjatë atyre viteve shënoi suksese në koncerte e festivale në Kosovë e Slloveni. Punën prej mësimdhënësi të historisë së muzikës e vazhdoi në Shkollën e Lartë Pe-

dagogjike në Prishtinë (1968-1975). Dispensa e tij “Historia e muzikës” (1975) ishte një kontribut i mirëpritur për literaturën e paktë universitare. Për dy dekada me radhë (1981-2000) botoi punime, vështrime, studime analitike për jetën dhe krijimtarinë muzikore në Kosovë e më gjerë. Ka marrë pjesë në tryeza e tribuna të ndryshme, në tubime shkencore, seminare, përvjetorë figurash muzikore etj. Ka publikuar serinë e zërave për artin muzikor në Kosovë në “Leksikon Jugoslavenske muzike” (Zagreb, 1984); autor i teksteve shkollore “Kultura muzikore” për klasët I-II për shkollën e mesme (Prishtinë, 1989) dhe i monografisë mbi Shoqërinë kulturore-artistike “Agimi” (bashkë me K. B. Shirokën, 1994). Ka ligjësuar pa ndërprerje një gjysmë shekulli lëndën historia e muzikës në të tri fazat e arsimimit muzikor, duke vazhduar edhe pas pensionimit si pedagog i jashtëm. Materien historike-muzikore brenda suazave universitare dhe të përmbledhur e ka paraqitur edhe në publikimin “Studime e vështrime për muzikën” (2004). Po atë vit ka botuar dhe tekstin shkollor “Arti muzikor” për të gjitha llojet e gjimnazeve (2004). Është ndërruar me një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh, ndër të cilat edhe me çmimin kombëtar për vepër jetësore “Niketë Dardani”, të Ministrisë së Kulturës (2014). (Arnisa Rexhepi)

BERISHA I. Engjëll (1962-). Poet. Lindi në Korenicë të Gjakovës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, të mesmin në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar në gazetën e studentëve “Bota sot”, më pas në arsim dhe në Bibliotekën “Ibrahim Rugova” të Gjakovës, ku prej vitesh është drejtor. Në periudhën 2005-2010 ishte kryetar i Klubit letrar “Gjon Nikollë Kazazi” të Gjakovës. Botoi përmbledhjet me poezi: “Dita me hënë e me nuse” (1991), “Avenytë e muzgut” (1994), “Gjarpri në shishe” (2000), “Çati eshtrash” (2003), “Kujtesë e dehur” (2003), “Rikrijimi i librit” (2006), pastaj librin me tregime “Diaspora shqiptare” (1993), monografitë: “Masakra e Mejës e Korenicës” (2005), “Roli edukativ i bibliotekave shkollore dhe publike në Kosovë” (2011), “Martirët e Korenicës” (2013). Poezitë e tij u shpërblyen në konkurse të ndryshme, u përfshinë në antologji dhe u përkthyen në gjuhë të ndryshme. Në vitin 2010 në SHBA u botua libri i tij “Kam shumë

kohë për një vit” (Have Much Times for an age”, ndërsa poezitë e tij u botuan në antologjinë e poetëve botërorë (“World Poetry”, Yearbook 2013) dhe në gjuhën spanjolle “Poetët e botës” (Poetas del Mundo, 2011). (Adil Olluri)

BERISHA Enver (1953-). Balerin. Lindi në Dubravë të Madhe të Pejës. Kreu shkollën e mesme të baletit në Shkup. Në Teatër punoi tri sezona, pastaj emigroi në Amerikë. Mori pjesë në shfaqjet: “Ritma të zgjuara” dhe “Paralobje dasme”. (Selman Jusufi)

BERISHA Esat (1913-1944). Aktivist i lëvizjes kombëtare para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Medresenë e Madhe në Shkup (1935). Fakultetin Juridik e regjistroi në Beograd dhe diplomoi në Zagreb (1943). Gjatë kohës së studimeve në Beograd u angazhua në organizatën e rinisë përparimtare të Kosovës “Kosmet”. Më 1937 nënshkroi Proklamatën kundër shpërnguljes së shqiptarëve me dhunë për në Turqi, në bazë të marrëveshjes jugosllavo-turke. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u angazhua për përfshirjen e të gjitha trojeve etnike brenda shtetit shqiptar. Bashkëpunoi me shumë gazeta e revista të kohës. U mor edhe me sport. Luante në klubin “Bashkimi” të Gjilanit dhe ishte anëtar i këshillit drejtues. Punoi si gjyqtar i Gjyqit Paqësues për nënprefekturën e Gjilanit. Ishte delegat i Gjilanit në Kuvendin Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ku u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror (KQ). Në korrik të vitit 1944 caktohet përgjegjës për dikasterin e transportit në Qeverinë e Tiranës. Pas 17 nëntorit 1944, nuk u largua nga Kosova, si shumë nacionalistë të tjerë. U arrestua nga OZN-a dhe u pushkatua më 18 dhjetor, me akuzën se kishte qenë anëtar i KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Më pas ia vranë të atin, ndërsa vëllanë ia dënuan me burg të përjetshëm. (Fehmi Rexhepi)

BERISHA Etrit (1989-). Futbollist. Lindi në Prishtinë. Filloi të luante futboll me klubin KF “2 Korriku”, ku qëndroi për katër vjet, para se t’i bashkohej skuadrës suedeze “Kalmar” më 2008. Pasi luajti 14 ndeshje në stinorin e tij të parë si debutues, Berisha u bë portieri i parë i “Kalmarit”. Në vitin 2013 nënshkroi kontratë me “Lazio”, kurse debutoi në ndeshjen e fazës së grupeve të Ligës së Europës kundër “Apollon Limassol”. Kulmin e tij me “Lazio”

e arriti në “derby della capitale” (kryendeshjet e kryeqytetit), kundër rivalit lokal “Roma”, ku ai ndihmoi skuadrën që të merrte një barazim (0:0), duke u shpallur lojtari i ndeshjes. Në maj të vitit 2012 Berisha u ftua nga përzgjedhësi i përfaqësueses së Shqipërisë, Xhani de Biasi (Gianni De Biasi), për të luajtur në dy miqësoret kundër Katarit dhe Iranit. Berisha u bë hero i futbollit në Shqipëri në dy ndeshjet kundër Norvegjisë për mënjauset e Botërorit 2014, duke mos pësuar gol. Më pas ishte i pazëvendësueshëm edhe në ndeshjet e tjera mënjauese. Pas kualifikimit, me kombëtaren shqiptare u paraqit në pjesën përfundimtare të Kampionatit europian “Francë 2016”. Nga edicioni 2016/17 është pjesë e skuadrës së elitës italiane “Atalanta”. (Baki Berisha)

BERISHA Faton (1968-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, studimet e matematikës i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1991, ku përfundoi studimet pasuniversitare (1996) dhe ato të doktoratës (1998). Kontributi shkencor i tij i takon analizës Fourie, teorisë së përafërimeve



FATON BERISHA

dhe analizës numerike. Është autor dhe bashkautor i punimeve shkencore dhe mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore në rajon dhe në Europë. Për qëllime studimore qëndroi për specializim në disa universitete: Moskë, La Rochelle (Francë), Jenë dhe Budapest. Një kohë punoi mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, më pastaj zgjidhet asistent në FSHMN të UP-së (1995), docent (1999) dhe profesor i rregullt (2004). Ka mbajtur ligjërata nga lëndët analiza numerike dhe programim dhe algoritma. (Qamil Haxhibeqiri)

BERISHA Fatos (1966-) Regjisor i teatrit. Studimet për regji teatri deri në nivelin master i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Qysh si student krijoi profilin e tij si regjisor dhe për një kohë të shkurtër bëri karrierë në teatër, film dhe televizion. Ne teatrin “Dodona” realizoi shfaqjet “Makbethi” (1996),

“Audienca” (1997), “Mondi dhe lodrat e tij” (1999), ndërsa në Teatrin Kombëtar të Kosovës realizoi shfaqjet “Hamleti” (bashkëregjisor me David Gothard, 2000), “Vdekja dhe vasha” (2008), “Beselam, pse më flirtojnë” (2010), dhe “Shopping and fucking” (2015). Është themelues i “Teatrit Urban” ku punoi disa shfaqje në bashkëprodhim me teatrin “Dodona” dhe Teatrin Profesionist të Gjilanit, Mitrovicës dhe me Teatrin Kombëtar të Kosovës. Si regjisor i filmit dhe i televizionit u bë i njohur me serialin televiziv “Familja moderne”. Realizoi edhe disa drama televizive dhe filma dokumentarë me CMB Production & Cani Company. Është bashkëthemelues dhe drejtor artistik i Festivalit ndërkombëtar të filmit “Pri filmFest”. Nga viti 2011 deri 2013 ishte drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës. Është anëtar i Akademisë Europiane të Filmit dhe i Parlamentit Kulturor Europian. (Fadil Hysaj)

BERISHA Fazli (1953-). Gazetar i sportit. Lindi në Vasilevë të Drenasit. Një kohë ishte aktivist në organizimet sportive. Me gazetari filloi të merret prej vitit 1997, kur filloi të shkruante për gazetën “Kosova sot”. Gjatë luftës raportoi për gazetën “Fakti” të Shkupit, kurse pas luftës një kohë të shkurtër qe gazetar i sportit në “Kosova sot”. Më pas ushtroi detyrën e redaktorit të sportit në gazetën “Bota sot” deri në vitin 2013. Punoi në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit dhe ishte zëdhënës Federatës së Futbollit të Kosovës. (Florim Maliqaj)

BERISHA Fevzi (1955-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Suharekë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, studimet e matematikës i kreu në Fakultetin e Shkencave



FEVZI BERISHA

Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1979, ku mbrojtëti edhe temën e magistraturës dhe tezën e disertacionit. Interesimi shkencor i F. Berishës i takon fushës së serive trigonometrike dhe ana-

lizës reale e funksionale. Për specializim qëndroi në Universitetet e Moskës dhe të Leningradit. Është autor dhe bashkautor i punimeve shkencore dhe profesionale të botuar në revistat vendore dhe ndërkombëtare. Ka marrë

pjesë në tubime të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu është autor dhe bashkautor i disa teksteve për shkollë të mesme dhe i teksteve universitare (“Matematika III”, “Matematika për studentët e arkitekturës”). Ka kryer detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në ato shtetërore të Kosovës. (Qamil Haxhibeqiri)

BERISHA Hamdi (1925-1992). Veprimtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në gjuhën serbe në Gjilan, kurse më 1942 regjistroi gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Si nxënës i gjimnazit bashkëpunoi me profesorin e tij Gjon Serreqin dhe filloi veprimtarinë në LNDSH. U angazhua për themelimin e komiteteve të rretheve dhe të fshatrave dhe mori pjesë në shumë mbledhje të Këshillit Qendror të LNDSH-së. Ndihte grupe me logjistikën e nevojshme, kryesisht me armë dhe ushqim. OZN-a i kishte rënë në gjurmë veprimtarisë së tij dhe më 14 korrik 1946 arrestohet. Gjykata e dënoi me pushkatim, më pas dënimi iu shndërrua në 20 vjet burg. I vuajti dhjetë vjet burg në Gjilan, Prishtinë, Nish, Mitrovicë së Stremit etj. Pas lirimit nga burgu, punoi si kontabilist në Kombinatin e Duhanit në Gjilan deri më 1981, kur edhe paralizohet. (Naim Musliu)

BERISHA Ibrahim (1955-). Sociolog, gazetar, shkrimtar, profesor universiteti. Lindi në fshatin Sllatinë të komunës së Fushë-Kosovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në



IBRAHIM BERISHA

Prishtinë, ku kreu edhe studimet për filozofi-sociologji, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Politike në Zagreb dhe në Fakultetin Juridik në Prishtinë.

U doktorua në fushën e sociologjisë së komunikimeve në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Me shkrime nisi të merret që në moshë të re, kur publikoi poezi në revistën “Pionieri”. Vazhdoi të merret me gazetari dhe letërsi në revistën e studentëve “Bota e re” dhe në revistën për të rinj “Zëri”. Në periudhën 1978-1999 punoi gazetar dhe më pas redaktor i kulturës në

gazetën "Rilindja" dhe "Bujku", pastaj në revistat "Fjala", "Ora", "Ekskluzive", "Albanica" etj. Ishte njëri nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (1989) dhe i Qendrës për Informim të Kosovës (1990). Nga viti 2001, punoi si ligjërues i gazetarisë dhe sociologjisë së komunikimeve në institucione të arsimit të lartë, pastaj në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të UP-së, ku vazhdon të jetë profesor i lëndëve nga fusha e komunikimeve dhe sociologjisë së kulturës. Studimet e tij janë përqendruar në sociologjinë e medias dhe të kulturës. Ka botuar disa libra me tregime: "Fryma e shiut" (1983), "Te martën mbrëma" (1987), "Origjina e rinjohjes" (1997), "Gruaja e vetmisë" (2000), etj.; pastaj libra me poezi: "Gur që nuk prekesh" (1982), "Lakimi i erërave" (1986), "Sipërfaqja e së dielës" (1994) etj., si dhe disa libra publicistikë: "Media dhe tranzicioni" (2007), "Konvergenca intelektuale" (2009), "Vdekja e kolonisë" (2016) etj. Ka botuar punime shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit. Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në gjuhë të huaja. Për krijimtarinë letrare ka marrë disa çmime, si çmimin vjetor për librin më të mirë botuar në Kosovë ("Origjina e rinjohjes", 1997) ndarë nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, çmimin për librin më të mirë të prozës ("Gruaja e vetmisë", 2000) në Takimet "Naim Frashëri" në Tetovë, çmimin vjetor të Ministrisë së Kulturës për librin më të mirë me ese (2009) etj. (Anton K. Berishaj)

BERISHA Idriz (1953-). Pikturor. Lindi në Dobërdol të Klinës. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Klinë. Kreu Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Për shumë vjet ishte profesor i artit figurativ në gjimnazin e Klinës. Pati disa paraqitje me ekspozita individuale, si më 1994 në Galerinë "Vatra" në Prizren, më 1996 në Galerinë "Koha" në Prishtinë, pastaj më 2002 në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, në Galerinë e Arteve në Lezhë, në Kushnacht të Zvicrës, në Qendrën e Kulturës në Cyrih po në Zvicër, në Galerinë e Arteve në Ambyll në Francë (2011) etj. Mori pjesë edhe në disa ekspozita kolektive. Piktura e tij është e orientuar në kërkimet e një rruge drejt artit modern. Nga krijimtaria e tij dallohet cikli "Frymë anësie", në të cilin shpërfaq ambientin e Kosovës, godinat, oxhaqet, zjarrvëniet, masakrat. (Bislim Aliu)

BERISHA Kadri (1945-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, shkollën fillore e kreu

në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë. Studimet për kimi i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1970. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit (1974) dhe tezën e disertacionit të doktoratës nga lëmi i kimisë e mbrojti në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të UP-së (1986). Një kohë punoi mësimdhënës në disa shkolla të mesme. Më 1975 zgjidhet asistent në FSHMN të UP-së dhe në vitet vijuese merr të gjitha gradat universitare. Ka ushtruar detyra dhe funksione në institucionet e arsimit të lartë në Prishtinë dhe në Mitrovicë. Ka publikuar punime shkencore dhe ka mbajtur kumtesa në tubime shkencore vendore dhe ndërkombëtare. (Nexhat Daci)

BERISHA Kolë (1947-). Kryetar i Kuvendit të Kosovës, jurist. Lindi në fshatin Dobërdol të Klinës. Mësimet fillore i kreu në vendlindje, ndërkaq shkollën e mesme e përfundoi në Gjakovë. Studimet për drejtësi i kreu në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësues në Ujëmir dhe Gllarevë, ndërkaq nga vitit 1973 ishte sekretar i gjimnazit "Luigj Gurakuqi" në Klinë. Në vitin 1989 u izolua me grupin e të dënuarve politikë, me ç'rast qëndroi 3 muaj në burgjet e Leskocit, Beogradit dhe të Pejës. Pas liritimit nga burgju u përjashtua nga puna. Me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) u përfshi në strukturat lokale të kësaj partie, si dhe të Komisionit për pajtimin e familjeve të hasmëruara. Në vitin 1998 u zgjodh nënkryetar i LDK-së, ndërsa pas luftës së vitit 1999 ishte anëtar i Këshillit Transitor të Kosovës. Në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2004 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. Ishte anëtar i Grupit Politik Strategjik për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës dhe kryetar i Parlamentit të Kosovës (2006-2008). Në vitin 2010 u tërhoq nga jeta politike për shkaqe shëndetësore. Ka të botuara disa vepra, si: "Ditari i një izolanti" (1991), "Kosova, plagë që pikon" (1997), "Dajhtë nuk flenë" (2008) etj. (Mrika Limani)



KOLË BERISHA

BERISHA Kristë (1922-1982). Aktor, regjisor, dramaturg. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën



KRISTË BERISHA

fillore dhe të mesme. Ishte njëri ndër pionierët e aktrimit, të dramaturgjisë dhe të regjisë në Kosovë. Në Teatrin Popullor Krahinor u angazhua që nga viti 1945, fillimisht në Prizren e më pas në Prishtinë. Realizoi role të rëndësishme

në skenën e teatrit në shfaqjet: “Dy rreshterë” (1953), “Autobiografia” (1962), “Po shkoj në gjah” etj. Po në TPK interpretoi role edhe në shfaqjet: “Besa”, “Zullumçari”, “Pylli”, “I ndjeri”, “Paradoksi i Diogjenit”, “Nuk martohem me parë”, “Vinetu”, “Dredhitë e Shaptukut”, “Hanka”, “Tri ditët e kiametit”, “Halili dhe Hajria”, “Hotel Kashta”, “Makbethi” etj. Është autor i komedive “Kryet e hudrës” (1956), “Lugati” (1958) dhe “Peripetitë e kohës” (1962), në të cilat artikuloohen veset, të metat dhe paragjykimet e kohës. Bëri regjinë e shfaqjeve: “Peripetitë e kohës” (1962), “Tri ditët e kiametit” (1969), “Korbi” (1970), “Mjalti i hidhur” (1973), “Ngadhënjimi” (1981). Për suksesin e tij në teatër u vlerësua me disa çmime. Vdiq në vitin 1982. (Arian Krasniqi)

BERISHA Labinot (1969-). Studiues i letërsisë. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollën fillore e të mesme. U diplomua më 1999 në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ku kreu edhe studimet pasuniversitare. Në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2010). Nga viti 1993 bashkëpunoi me revistën “Shpresa”, në fillim si gazetar e më vonë edhe si redaktor. Shkroi dhe botoi disa studime mbi letërsinë gojore. Një kohë punoi në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Botoi dy libra studimorë: “Kulti kalorësiak në këngët kreshnike shqiptare” (2006) dhe “Këngët kreshnike shqiptare dhe epet e lashta” (2013). (Hasan Hasani)

BERISHA Latif (1931-1999). Poet, studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Smrekonicë, komuna e Vushtrrisë. Mësimet e para i kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Vushtri dhe në Prishtinë. Punoi si mësues, mësimdhënës i gjuhës shqipe, inspektor i arsimit. U diplomua në Fakultetin Filo-



LATIF BERISHA

zofik të Universitetit të Beogradit më 1959, në degën e albanologjisë. Më pas vazhdoi studimet pasuniversitare. Poezitë e para i botoi në revistën letrare “Jeta e re”. Më 1965 u pranua asistent në Fakultetin Filozofik të Prishtinës,

në katedrën e albanologjisë, ndërsa në vitin 1968 ligjërues për lëndën historia e letërsisë së re shqipe (romantizmi). Ishte pjesëmarrës aktiv në zhvillimet politike të viteve '90, kryetar i degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Mitrovicë. Në vitin 1991 udhëheqja serbe e Fakultetit Filozofik e përjashtoi nga puna. Vazhdoi punën si profesor i këtij fakulteti deri më 1992, kur u pensionua. Më 24 mars 1999 u vra mizorisht nga forcat e pushtetit serb në Mitrovicë. Veprat e tij të botuara janë: “Tufa” (1957), “Vepra” (2002). Studimet letrare u kushtohen shkrimtarëve shqiptarë, si: Naim Frashërit, Jeronim de Radës, Zef Serembes, Hil Mosit, Luigj Gurakuqit, Ali Asllanit etj. Në shenjë nderimi Biblioteka Komunale e Mitrovicës mban emrin e tij. (Isak Shema)

BERISHA Mandushe (1942-). Kimiste, profesoreshë universiteti. Lindi në Gjakovë (1942). Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në degën e kimisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës (1968). Punoi në Shkollën Teknike në Prishtinë. U zgjodh asistente në degën e kimisë (1968) dhe ligjëruese në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) më 1974. Kreu studimet pasuniversitare në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1982), tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1987). Publikoi punime në disa revista shkencore, kumtesa, projekte. Është autore e teksteve shkollore. (Salih Gashi)

BERISHA Marash (1927-2011). Gazetar, përkthyes. Lindi në Podgoricë. Mësimet e para i mori në Shkodër, ku jetoi deri në vitin 1947. Ishte njëri ndër maturantët e parë të gjimnazit të Prishtinës. Studimet për gjuhët romane i kreu në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. Me gazetari filloi të merret në vitet '50 në Radio-Titograd dhe Radio Prishtinë, e më pas punoi spiker, përkthyes dhe gazetar

në redaksinë shqipe të Radio-Jugosllavisë në Beograd. Nga viti 1968 punoi në redaksinë shqipe të Televizionit të Beogradit dhe më pas në Televizionin e Prishtinës (TVP). Në vitet '80 ishte korrespondent i TVP-së nga Beogradi. Punën e gazetarit e vazhdoi edhe pas pensionimit. Deri në vitin 2007 punoi korrespondent i Radios "Europa e lirë" nga Beogradi. Ka punuar edhe për shumë media të tjera, si gazetar dhe përkthyes. Vdiq në Beograd. (Rahman Paçarizi)

BERISHA Mejreme (1960-). Aktore. Lindi në Gjilan, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjilanit. Punoi si aktore në Teatrin e Gjilanit nga viti 1976. Në këtë teatër luajti role të shumta në një sërë shfaqjesh, si: "Dasmë në Luftë", "Banesa e përbashkët", "Miu në xhëp", "Princi i hijevë", "Drenusha", "Familja e shenjtë", "Hamleti nga Katranica e poshtme", "Kush nuk vdes nuk është njeri", "Vdekja e një mbretëreshë", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Bunari afër shëpës", "Miza në vesh", "Beselam pse më flijojnë", "Ëndërr apo zhgjëndërr", "Mos e prek", "Romeo dhe Zhulieta", "Ligatina", "Vegullia", "Ditëlindja", "Kopshti me lule", "Pacienti i dr. Frojdit", "Rekuiem" etj. U nderua me një sërë çmimesh për kreacione artistike, si: Medaljoni i Artë në Festivalin e Teatrove në Kullë të Vojvodinës (1976), aktorja më e mirë në Festivalin Ballkanik të Monodramës në Korçë, aktorja më e mirë në Festivalit e Teatrove Shqiptare në Gjilan etj. Është aktore rezidente në Teatrin e Gjilanit. (Erson Zymberi)

BERISHA Milaim (1945-2015). Poet. Lindi në Graboc të Poshtëm të Fushë Kosovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Shkollën e Mesme Ekonomike në Prishtinë, ku më pas mbaroi edhe studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Disa vjet punoi si gazetar, më pas ishte kryeredaktor i gazetës „Elektrokosova“ dhe më vonë redaktor i gazetës "Kosova" të Elektroekonomisë së Kosovës. Së fundi ishte redaktor i shtojcës për kulturë po në këtë gazetë. Shkroi poezi për fëmijë dhe të rritur. Botoi veprat: "Epshet e gjakut (1968)", "Pranë burimit (1987)", "Bukureza (1990)", "Biografia e popullit tim" (1995), "Testament për Kosovën" (2000), "Pranvera në Prishtinë" (2006), "Testament për Shqipërinë" (2008).

Bashkëpunoi me revistat letrare të Kosovës dhe të mbarë hapësirës shqiptare. Poezitë e tij janë frymëzuar nga ngjarjet e rëndësishme të historisë sonë kombëtare, i karakterizon revolta e fuqishme dhe prirja për t'u ngritur në lartësinë e idealit të kohës. (Nazmi Rrahmani)

BERISHA Muharrem (1942-2010). Matematikan, profesor universiteti, akademik. Lindi në fshatin Vilanc, komuna e Vushtrrisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën Normale



MUHARREM
BERISHA

në Prishtinë (1961). Kreu studimet për matematikë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1966), ndërsa studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1974). Tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1979. Që më 1967 zgjidhet asistent në degën e matematikës të Fakultetit të Filozofik të UP-së dhe më vonë në FSHMN të UP-së, po në degën e matematikës, i merr të gjitha gradat universitare. Ishte i angazhuar profesor edhe në Fakultetin Ekonomik të UP-së dhe në Universitetin e Tetovës. Ligjëroi lëndët analiza I, II dhe III në departamentin e matematikës të FSHMN-së dhe kurse speciale nga teoria e serive Fourie në studimet pasuniversitare të këtij departamenti. Ishte udhëheqës i seminarit nga analiza matematike në studimet pasuniversitare. Mbajti edhe kurse të përgjithshme të matematikës në fakultete të tjera të Universitetit të Prishtinës. Interesimi shkencor i tij i takon fushës së analizës matematike, e në veçanti serive Fourie. Opusi i tij shkencor përfshin punime shkencore, si autor dhe bashkautor, të publikuara në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rezultatet e tij i kumtoi në tubime të ndryshme shkencore. Ishte udhëheqës dhe pjesëmarrës në disa projekte shkencore. Për qëllime studimore e hulumtuese qëndroi në universitete të ndryshme. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe anëtar i rregullt në vitin 2000. Ishte kryeredaktor i revistës "Kërkime", redaktor i revistës "Punime matematike", korrespondent i revistës "Mathematical Reviews", anëtar i Shoqatës Amerikane të

Matematikanëve (AMS). Kreu funksione dhe detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. (Qamil Hxhibeqiri)


BERISHA Nagip (1954-). Pikturor. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1977). Punoi në shkollat e mesme në Gjilan deri në vitin 2000. Është i njohur me imazhet e bukurisë piktoreske dukagjinase dhe me shprehjen lirike të ekspresionizmit abstrakt, të një emocioni apo ideje, që transmeton forma objektive të kombinimit të ngjyrave. Është anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe ka organizuar disa ekspozita personale: në Prishtinë, në foajeun e Teatrit Popullor (1982); në St. Gallen të Zvicrës, në sallën ekspozuese të qytetit (1995); në Prizren, në Galerinë “Rada” (1995); në Prishtinë, në Galerinë “Dodona” (1997); në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë (2003), në Tiranë, në Muzeun Historik Kombëtar (2013) etj. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. Është mësimdhënës i pikturës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Hajrush Fazliu)

BERISHA Jashar Nak (-1925). Luftëtar i lëvizjes çlirimtare. Lindi në fshatin Turiqec të Drenicës. Në masakrën e Turiqecit më 6 maj 1918 ushtria serbe, në mesin e 18 burrave, vrau edhe vëllanë e N. Berishës. Pasi identifikoi xhandarët, të cilët kishin shkuar në kishën e Belicës për të festuar së bashku me Sadri Islam Shalën nga Leçina i vranë kriminelët. Pas kësaj ngjarjeje, naçallniku i Rakoshit i ftoi krerët shqiptarë me ndikim për një marrëveshje armëpushimi. Shqiptarët kërkuan që të ndalen vrasjet, burgosjet dhe dhuna mbi popullatën. Forcat serbe kërkuan dorëzimin e armëve, por N. Berisha me shokë e vazhduan luftën. Pushteti serb, në shenjë hakmarrjeje, më 3 mars 1920 dërgoi forca të ushtrisë dhe të xhandarmërisë, të cilat ia vunë zjarrin Kërrninës, pa kursyer gra, fëmijë e pleq. Me çetën e Kërrninës, më 25 korrik 1922 N. Berisha sulmoi stacionin e xhandarmërisë në Rakosh. Nuk e ndali luftën as pas vrasjes së Azem Galicës. Pushteti serb shpalli shpërblime për ata që do ta zinin ose ta vrisnin. U vra më 21 gusht 1925 në përpjekje për të shpërthyer rrethimin e ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe. (Muhamet Shatri)

BERISHA Nol (1923-1997). Mësimdhënës dhe krijues letrar. Lindi në Gurrec të Tuzit, në

Mal të Zi. Shkollën fillore dhe gjysmëmaturën i kreu në Shkodër, për të vazhduar në Tiranë, ku kreu edhe dy kurse pedagogjike. Studioi gjuhë e letërsi shqipe në Prishtinë. Në vitet 1946-1949 ishte mësues në disa fshatra të Kukësit dhe më pas në Drume, Arzë, Kshevë dhe Gurrec, ndërsa prej vitit 1959-1984 ishte mësues në Ferizaj. N. Berisha ka shkruar vepra letrare për fëmijë dhe të rritur. Ishte bashkëpunëtor i revistave për fëmijë “Gëzimi”, “Fatosi” dhe “Shkollari” në Prishtinë, me punime origjinale dhe përkthime nga italishtja. Botoi dy vepra për fëmijë: “Shtëpia në blerim” dhe “Si u mësua Frani të lexojë” dhe disa artikuj me karakter gjuhësor. (Palokë Berisha)

BERISHA Nuhi (1961-1984). Veprimtar i lëvizjes ilegale. Lindi në Svirçë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Gjilan. Si nxënës gjimnazi u përfshi në veprimtari ilegale. Ndërkohë vijoi studimet në Fakultetin Juridik dhe në Fakultetin e Edukatës Fizike në Prishtinë. Mori pjesë aktive në demonstratat e vitit 1981 dhe mbajti shënime për demonstratat e Prishtinës nga 26 marsi deri më



NUHI BERISHA


2 prill. Veprimtarinë ilegale e zhvilloi në kuadër të organizatës Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi. Në shkurt të vitit 1982 emigroi në Zvicër, ku qëndroi deri në tetor të po atij viti. U kthye në Kosovë, për të zhvilluar aktivitet në ilegalitet të plotë, së bashku me Rexhep Malën. N. Berisha u mor edhe me shkrime. Në emigracion iu botuan veprat “Pranvera e luleve të kuqe”, në të cilën pasqyron ngjarjet e vitit 1981 dhe “Mbi organizimin”, ku jep ide dhe sugjerime rreth organizimit të veprimtarisë ilegale. Shkroi edhe poezi. Pasi organet e sigurimit dhe të ndjekjes i kishin rënë në gjurmë, më 11 janar 1984, së bashku me Rexhep Malën, u rrethuan nga forca të mëdha policore në lagjen Vranjevc (sot Kodra e Trimave) në Prishtinë, ku të dy ranë duke luftuar. (Zijadin Gashi)

BERISHA Palokë (1935-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Gurrec të Malësisë së Madhe, komuna e Tuzit, në Mal të Zi. Shkollën fillore e kreu në Kshevë, përkatësisht në Tuz. Kreu shkollën Normale të Prishtinës, ndërsa

studimet për pedagogji i filloi në Universitetin e Sarajevës dhe i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Magjistroi në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ku më pas doktoroi me temë mbi arsimin e shqiptarëve në Mal të Zi. Nga viti 1959 u mor me veprimtari arsimore, publicistike dhe me kërkime shkencore. Ishte mësues në vendlindje, profesor në Normalen e Ferizajt, edukator në konviktin e Normales së Prishtinës dhe profesor i metodikës së punës edukative në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Mbajti mësim edhe në Fakultetin e Mësuesisë në Podgoricë. U mor me veprimtari kërkimore-shkencore, kryesisht në fushën e historisë së arsimit të shqiptarëve në Mal të Zi, të pedagogjisë së konvikteve dhe asaj shkollore. Është autor i disa veprave të veçanta: “Puna edukativo-arsimore në konviktet e Kosovës” (1986), “Zhvillimi i shkollave dhe arsimit të shqiptarëve në Mal të Zi, prej vitit 1878 deri në vitin 1988” (1997), “Meteorët e arsimit shqip në Mal të Zi 1916-1971” (2007), “Punime nga shkencat humanitare” (2011), “Marrëdhëniet ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit në procesin mësimor” (2011) etj. Ka marrë pjesë në disa aktivitete profesionale-shkencore. (Hajrullah Koliqi)

BERISHA Patris (1986-). Perkusionist. Lindi në Prishtinë. Mësimet e para dhe Shkollën e Mesme të Muzikës i kreu në Prishtinë. Përfundoi studimet në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës, drejtimi teorik. Nga viti 2008 timpanist i Orkestrës së Filarmonisë së Kosovës. Studioi në drejtimin për perkusione dhe u diplomua më 2013 si perkusionist i parë në Kosovë në Fakultetin e Muzikës në Shkup. U prezantua si solist me Orkestrën e Filarmonisë së Kosovës. Ishte mësimdhënës i perkusioneve për moshat e reja në shkollën private të muzikës “Misbah & Friends”. Eshtë timpanist në Orkestrën Kamerale Ballkanike me dirigjent T. Yanagisawa, ka qenë anëtar i “Young European Orchestra” në Berlin, anëtar i Orkestrës “NBO”, si dhe rreshter i sektorit të perkusioneve në Orkestrën Frymore të FSK-së. Në sajë të shkathtësive prej perkusionisti të talentuar mori pjesë në koncerte brenda e jashtë vendit. (Sami Piraj)

BERISHA Rifat (1910-1949). Veprimtar ushtarak dhe politik në Shqipëri dhe në Kosovë. Lindi në Berishë të Drenicës, në Gjakovë kreu



RIFAT BERISHA

shkollën fetare për hoxhë, por kurrë nuk e ushtroi këtë profesion. Më 1926 shkon në Shqipëri dhe vendoset në konviktin “Naim Frashëri”, i cili ishte strehë për refugjatët e Kosovës. Atje vazhdoi shkollimin, ku u njoh me Asim Vokshin, Fadil Hoxhën, Emrush Miftarin etj. Ndoqi shkollimin për oficer dhe më 1931 u diplomua me gradën aspirant. Në periudhën 1931-1941 shërbeu në ushtrinë shqiptare, në trupën e rojës së kufirit në Vlorë, në Shkodër dhe në Sarandë. Ishte ndër ushtarakët që kundërshtoi pushtimin fashist të Shqipërisë më 1939. Pas kapitullimit të Jugosllavisë u kthye në Kosovë dhe u emërua nënprefekt i Gjilanit (1942). Në verë të vitit 1943 u transferua në Rahovec, ku ushtroi detyrën e nënprefektit. Bashkëpunoi me Lëvizjen Antifashiste dhe ndihmoi të shpëtojë nga rrethimi aradhën partizane “Emin Duraku”, e cila komandohej nga Fadil Hoxha, në malet e Poneshit (26 prill 1943). Për shkak të aktivitetit antifashist burgoset nga karabinieria italiane dhe nga Prizreni dërgohet në burgun e Shkodrës, prej nga u arratis. Mori pjesë në Konferencën e Bujanit, ku u zgjodh nënkryetar i kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit. Pas Luftës së Dytë Botërore u zgjodh në funksione me rëndësi në administratën dhe qeverisjen krahinore, përfshirë edhe deputet federativ në dhomën e kombeve dhe të kombësive. Më 1947 shkoi në Tiranë, ku u takua me disa nga udhëheqësit e shtetit shqiptar, të cilëve u shpjegoi gjendjen e rëndë në Kosovë. Pas kthimit nga Shqipëria filloi të ndiqej nga organet e sigurimit, së pari u shkarkua nga të gjitha funksionet dhe më pas u burgos. Më 14 maj 1944 arriti t’u shpëtojë agjentëve të UDB-së, por më 17 maj u rrethua në Gajrak të Malishevës, bëri rezistencë, por u vra së bashku me dy vëllezërit e tij. (Fehmi Rexhepi)

BERISHA Ruzhdi (1952-1999). Aktivist i lëvizjes kombëtare, dëshmor nga Opoja. Lindi në fshatin Buçe të komunës së Dragashit. Pas përfundimit të shkollës së mesme në Prizren, punoi si mësues në vendlindje. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë dhe punoi si

mësimdhënës në gjimnazin “Emin Duraku” në Dragash. Në fillim të viteve ‘90 ishte aktivist dhe anëtar i kryesisë së Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë (LASH) për komunën e Dragashit, pastaj i degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës, veprimtar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, si dhe deputet i parlamentit të pakonstituuar të Kosovës. Në qershor të vitit 1998 në Tiranë mori përsipër organizimin e njësiteve të UÇK-së në trevën e Opojës. Pas luftës, në shtator të vitit 1999 u gjet i vrarë në malin Pikëllimë, afër kufirit me Shqipërinë. (Nuredin Ahmeti)

BERISHA Rrok (1956-). Gazetar. Lindi në Gllugjan të Lugut të Baranit, komuna e Pejës. Gjimnazin e kreu në Prishtinë, ndërsa studioi për biologji dhe kimi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1978 punoi si gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës, në programin informativ-politik. Gjatë viteve ‘90 bashkëpunoi me Qendrën për Informim të Kosovës, me gazetën “Bujku”, “Informatori” etj. Në këtë periudhë u përfshi edhe në zhvillimet politike, duke u bërë njëri nga themeluesit e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës. Më pas mori pjesë në luftën çlirimtare dhe ishte përgjegjës për informim në Brigadën 131 të njësiteve operative të UÇK-së në Baran. Botoi disa vepra poetike “Ti aty mbush ujë”, “Kërkimi i vetvetes”, “Vetmia e udhëtimit” etj. si dhe librat publicistikë “Krimbi në mollë”, “Bardh e zi”, “Kukullat”, “Shitësit e mjegullës” etj. Është pronar i Shtëpisë Botuese “Fishta” në Prishtinë. (Shaqir Foniqi)

BERISHA Rrustem (1938-). Studiuës dhe mbledhës i folklorit, poet. Lindi në Godishnjak të Besianës. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi, studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (1986). Punoi në gazetari dhe në arsim, kurse nga viti 1973 bëhet punonjës shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës (IAP). Ka qenë përgjegjës i degës së folklorit në këtë institucion shkencor dhe, për shumë vjet, kryeredaktor i revistës shkencore “Gjurmime albanologjike - Folklor dhe etnologji”. Është marrë me stilin dhe figuracionin, si edhe me aspekte të tjera të letërsisë popullore. Nga kjo fushë ka botuar: “Personifikimi në poezinë popullore shqiptare” (1976), “Stili dhe

figuracioni i poezisë popullore shqiptare” (1986), “Komunikime artistike të këngës popullore” (2006), “Dimensione të këngës popullore” (2011), “Personalitet të folklorit tonë” (2013) etj. Rr. Berisha ka mbledhur folklor në shumë vise shqiptare: në arkivin e IAP-it ruhen 24 vëllime me materiale të mbledhura në terren. Ka marrë pjesë në përgatitjen e botimeve të disa vëllimeve të krijimtarisë popullore, kryesisht të këngëve popullore historike dhe të dashurisë. Ka botuar edhe disa përmbledhje me poezi (“Bredhje intime”, “Qëndresa e emrit”, “Guri i Gjeranës” etj.), prozë për fëmijë dhe publicistikë. (Sadri Fetiu)


BERISHA Rrustem (1965-). Veprimtar politik, luftëtar, ushtarak. Lindi në fshatin Dobërdol të komunës së Pejës. Kreu Akademinë Ushtarake për oficer këmbësorie. Në vitet 1998-1999 mori pjesë në luftën çlirimtare në Kosovë. Ishte pjesëmarrës në disa beteja kundër ushtrisë serbe në Kosovë, si në Koshare më 9 prill të vitit 1999 në kuadër të operacionit “Shigjeta”. Rr. Berisha ishte komandant i Brigadës 138 “Agim Ramadani” dhe shef i Shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit. Pas mbarimit të luftës ishte komandant i Akademisë së Mbrojtjes të Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe më pas zëvendëskomandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pas përfundimit të karrierës ushtarake, mori angazhime politike në radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). U zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës i legjislaturës së pestë (2014) nga radhët e AAK-së. (Bedri Muhadri).

BERISHA Safet (1982-). Kontratenor. U diplomua në klasën e prof. Ahmet Dërgutit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është solist dhe anëtar i rregullt i Korit të Filarmonisë së Kosovës dhe anëtar i Ansambllit vokal “Okteti +”. Nga viti 2016 është bashkëpunëtor i Ansambllit “Albanian Baroque ensemble” me seli në Itali. Si kontratenor debutoi më 2011 me koncert recital dhe që nga ajo kohë ka pasur shumë prezente në Kosovë, në Shqipëri, Maqedoni, Britani dhe Itali. Në bashkëpunim me partneren e tij, sopranon Kaltrina Miftari shquhen për prezentimet e shpeshta dhe përkushtimin ndaj muzikës së periudhës së renesansës dhe barokut. (Besa Luzha)

BERISHA Sejdi B. (1947-). Shkrimtar dhe publicist. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe

gjimnazin i kreu në Pejë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Poezitë e para i botoi në gazetën “Flaka e vëllazërimit” të Shkupit, në revistën “Pionieri” dhe në shtojcën për fëmijë të gazetës “Rilindja”. Më 1972 u punësua në Radio-Prishtina si korrespondent nga Peja, ku punoi deri në mbyllje të këtij institucioni nga pushteti serb, në korrik të vitit 1990. Një kohë ishte edhe gazetar-korrespondent i Televizionit të Prishtinës dhe gazetar i “Rilindjes”. Është themelues i Radio-Pejës (1981). Ka botuar një sërë veprash në prozë, poezi, eseistike, monografi, dramë, kritikë letrare etj. Nga fusha e eseistikës botoi librat: “Përtej shkrimit” (2013) dhe “Konflikti me vetveten” (2016). Ka botuar edhe këto vepra: “Lumturia e dhembjes (2002), “Piramida e ironisë” (2004), “Fjala e gjaku” (2006), “E bukura e rrugëtimit” (2008), “Fjalë e pathënë” (2009), “Në lumë bie shi” (2015) etj. Ka fituar disa çmime letrare dhe publicistike. (Nazmi Rrahmani)

BERISHA Skënder (1942-2016). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Gjiilan, ku mori arsimin bazë, ndërsa studimet e larta për ekonomi, përfshirë edhe studimet pasuniversitare,



SKËNDER BERISHA

i përfundoi në Beograd. Në vitin 1967 filloi punën në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në fillim asistent, duke u avancuar më vonë në të gjithë titujt universitarë. Për shumë vite mbajti ligjërata nga fusha e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare, të financave ndërkombëtare dhe të integritimeve ekonomike europiane. Në vitin 1978 në Universitetin e Sarajevës mori titullin doktor i shkencave ekonomike. Krahas punës pedagogjike, në dy mandate ishte dekan i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Ushtri edhe një numër funksionesh në administratën shtetërore të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë, si ndihmësekretar Federativ i Tregtisë së Jashtme, sekretar Krahinor për Marrëdhënie me Jashtë dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Gjatë punës akademike publikoi disa tekste universitare: “Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare” (1998), “Financat ndërkombëtare” (2000), “Integrimet ekonomike europi-

ane” (2005) etj. Në revista të ndryshme botoi punime shkencore dhe profesionale, si dhe mori pjesë në një numër tubimesh shkencore brenda e jashtë vendit. (Sinan Ademaj)

BERISHA Shefqet (1935-). Mjek, internist, profesor universiteti. Lindi në Suharekë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e mbaroi në Prizren. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Rijekë të Kroacisë (1962). Pas diplomimit u punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Suharekë. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë kaloi në repartin e mjekësisë interne. Specializimin nga kjo fushë e filloi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup. U Orientua për nefrologji dhe bëri subspecializimin në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit. Mbrojti disertacionin e doktoratës për epidemiologjinë e nefropatisë endemike në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1980. Si ekspert i parë i kësaj fushe në Kosovë dha kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e nefrologjisë. Ishte themeluesi i repartit të parë të dializës në Kosovë. Mbajti mësim nga lënda e mjekësisë interne deri në pensionim. Si autor dhe bashkautor botoi shumë punime shkencore. (Ahmet Brovina)

BERISHA Shinasi (1946-). Gjyqtar i futbollit. Lindi në Vërban të Vitisë. Është gjyqtari më i njohur i futbollit i të gjitha kohëve në Kosovë. Provimin për gjyqtar fillestar e dha në vitin 1972. Më 1975 mori titullin e gjyqtarit të kategorisë së dytë, kurse në vitin 1977 edhe të kategorisë së parë. Në vitin 1983 mori titullin e gjyqtarit ndërkombëtar (FIFA). Në futbollin ndërkombëtar ndau drejtësinë deri në vitin 1989. Ishte i angazhuar që sporti i Kosovës të pavarësohet nga sporti i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë. Për disa vjet ishte drejtor i KF “Prishtina”, ndërsa kreu me sukses edhe detyrën e kryetarit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Futbollit të Kosovës. Së bashku me gjyqtarin Ismet Shurdhani është bashkautor i librit “Rregullat e lojës së futbollit”. (Baki Berisha)

BERISHA Shpresa (1956-). Këngëtare. Lindi në Suharekë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Filloi të këndojë në SHKA “Jehona” të Suharekës dhe si studente me Ansamblin “Ramiz Sadiku” në Prishtinë. U prezantua në festivalin “Zambaku i Prizrenit” (çmimi i publikut) dhe “Kosovarja këndon” në

Ferizaj, ku më 1974 fitoi të gjitha çmimet me këngën “Turtulleshë”. U paraqit në “Akordet e Kosovës” (“Sy jeshile gojë sheqere”) dhe u shpërblye si debutuesja më e suksesshme. Me grupin e Qamilit të Vogël këndoi në SHBA. Incizoi këngë popullore në RTP, u paraqit në festivale të ish-Jugosllavisë: në Magllaj (Bosnjë) fitoi shpërblimin e publikut, të jurisë dhe të interpretueses më të mirë. Në turnetë “Tinguj nga vendlindja” të Radio-Zagrebit u këndoi mërgimtarëve me udhëheqësin O. Mlakar. Më 1985 iu nda çmimi “Mikrofoni i artë” nga Radio-Prishtina. Si soliste e Ansambllit “Shota” vazhdoi t’i kontribuojë përhapjes së këngës sonë në Mal të Zi, Maqedoni, Serbi, Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Holandë, Luksemburg, Suedi, Danimarkë, Norvegji, Turqi. Incizoi me Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar. Kënga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” e Musa Piperkut e ka bërë shumë të njohur. (Sami Piraj)

BERISHA Tahir (1871-1953). Tregimtar popullor. Lindi në Berishë të Drenicës. Përmes tregimeve të tij ofroi të dhëna të shumta për ngjarjet në periudha të ndryshme historike, si dhe për doket dhe zakonet popullore. Kundërshtoi pushtetin osman, pastaj atë serb dhe bullgar. Mori pjesë në Kuvendin e Krojmiri (1920) dhe më pas ishte kryetar i komunës së Komoranit (1918-1938). Dha kontribut edhe në përhapjen e librave shqip dhe në zhvillimin e shkollës shqipe. Gjatë Luftës së Dytë Botërore vazhdoi veprimtarinë e tij kombëtare, duke u radhitur në anën e kundërshtarëve të bashkëpunimit me komunistët serb. Për shkak të këtyre angazhimeve u mbajt në burg në Prishtinë në vitet 1949-1952. (Skënder Lutfiu).

BERISHA Tahir (1928-2013). Veteran i arsimit, publicist. Lindi në Vërban, Viti. Shkollën fillore e kreu në Gërmovë, dy klasa të gjimnazit në Mitrovicë, diplomoi në Normalen e Pejës. Studioi gjuhë e letërsi shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shkupit dhe letërsinë jugosllave në Fakultetin Filozofik po në Shkup. Fillimisht ishte mësues (Bujanoc, Vërban, Gjilan, Prishtinë), pastaj mësimdhënës në gjimnaz, drejtor i shkollës ekonomike, drejtor i Entit Pedagogjik të Anamoravës, inspektor dhe kryeinspektor i arsimit të Kosovës, sekretar i Shoqatës së Veteranëve të Arsimit në Kosovë. T. Berisha u mor edhe me publicistikë. Ishte

redaktor i revistës “Gazeta e pionierëve” dhe bashkëpunëtor i disa gazetave të tjera. Është autor i disa veprave: “Trojet që nuk shuhen” (1993), “Emrat që nuk harrohen-arsimtarët veteranë I, II, III, IV” (1996), “Shënime dhe ecejake të një refugjati nga Kosova” (2001) etj. (Sabit Jaha)

BERISHA Tomë (1923-2012). Inxhinier i makinerisë, profesor, gjeneralmajor, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Pod-



TOMË BERISHA

goricë në Mal të Zi. Ishte pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare. Pas luftës ishte sekretar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Malësisë së Madhe dhe deputet i Asamblesë së Malit të Zi. Studimet i filloi në Fakultetin Teknik të Universitetit të Zagrebit dhe i kreu në Lubjanë (1953). Pas diplomimit, si kapiten i Armatës Popullore të Jugosllavisë, u emërua shef i seksionit projektues-teknologjik në oficinën kryesore të artilerisë të Armatës Popullore të Jugosllavisë në Zagreb. Në vitin 1955 emërohet mësimdhënës në Akademinë Ushtarake Teknike për lëndën projektimi i armëve artilerike. Në vitin 1957 vazhdoi specializimin në Bruksel, Belgjikë. Pas kthimit nga specializimi në Akademinë Ushtarake mbajti lëndën bazat e teknikës raketore, ndërsa në Fakultetin Kimiko-Teknologjik të Zagrebit ligjëroi lëndën termodinamika. Magjistroi më 1971, ndërsa doktoroi në vitin 1978. Nga viti 1971, për 20 vjet me radhë, duke udhëtuar nga Zagrebi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP), ligjëroi lëndët mekanika e fluideve dhe termodinamika, ndërsa lëndën e termodinamikës e ligjëroi edhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Më 1979 u zgjodh profesor inordinar, ndërsa në vitin 1980 profesor ordinar për lëndën mekanika e fluideve në Fakultetin Teknik të UP-së. Gjatë viteve 1978-1979 punoi si profesor i rregullt në Akademinë Ushtarake Kombëtare të Algjerisë, për lëndën motorët raketorë. T. Berisha kishte një veprimtari të gjerë botimesh shkencore, veçmas nga fusha e projektimit të motorëve raketorë. Për nevojat e studentëve ka hartuar disa tekste mësimore (“Dinamika e gazeve”,

“Mekanika e fluideve”etj.). Në vitin 2000 u zgjodh anëtarë i jashtëm i ASHAK-ut. (Fejzullah Krasniqi).

BERISHA Tomor (1948-). Kompozitor, aranzhues, pedagog. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme të muzikës. Studioi në Akademinë e Muzikës në Beograd. Puno



TOMOR BERISHA

noi në Radiotelevizionin e Prishtinës si pianist në orkestrën revyale, redaktor dhe producent. Ishte mësimpldhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. Kompozoi, harmonizoi e aranzhoi këngë të muzikës së lehtë, këngë popullore për kor e orkestër etj. Kënga e parë “Adriatiku” (1965) u këndua e incizuar nga Q. Dushku. Në “Akordet e Kosovës” fitoi çmime të jurisë profesionale, mirënjohje dhe disa herë “Okarinën e artë”. E përfaqësoi Kosovën në Festivalin e Opatisë, në përzgjedhjet për Eurovizion, në festivalet në Ilixha (Sarajevë), në Beograd, Zagreb, Shkup dhe Subotićë. Botoi përmbledhjet: “Melodi të lehta të paharruara shqipe” dhe “Këngë të zgjedhura në melosin popullor”. Kompozimet e tij janë incizuar në disqe LP, melogramet e harmonizuara të këngëve janë botuar në buletine festivalesh. Në gjininë e muzikës klasike, mbështetur në melosin tonë kompozoi “Variacione për kuartet harkor”. Dirigjoi me orkestrat e RTP-së, të Lubjanës dhe Beogradit. Këngët e tij u kënduan nga N. Pagaruasha, L. Çavolli, S. Fejzullahu, G. Pallaska, B. Islami, B. Krajku, V. Saraçini, L. Hajra, V. Oruçaj, B. Veletanliq, Z. Haxhimanov, S. Dimitrov etj. (Indira Çipa)

BERISHA Vesaf (1929-1977). Inxhinier i gjeologjisë. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, kurse studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit (1957). Pas diplomimit punoi në shërbimin gjeologjik të minierës së “Trepçës” në Stantërg, deri në vitin 1961 kur u zgjodh drejtor i Industrisë kimike në Mitrovicë. Më pastaj u emërua sekretar në Sekretariatit Krahinor të Këshillit Ekzekutiv për Industri, Komunikacion dhe Tregti (1965-1967), ndërsa në periudhën 1967-1969 ishte nënsekretar i Odës Ekonomike të Serbisë. Në vitet 1969-1974 ishte anëtar i Këshillit

Ekzekutiv të Serbisë, ndërsa në periudhën 1974-1977 ishte drejtor i përgjithshëm i Kombinatit “Kosova” në Obiliq. (Islam Fejza)

BERISHA Xhemali (1949-). Koreograf. Lindi në Buqë të Opojës. Pas shkollës fillore, kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren. U diplomua në Institutin e Lartë të Koreografisë në



XHEMALI BERISHA

Sofje. Merret me ngritjen e aftësive, cilësive të valles folklorike dhe realizimin e saj në ansamble të ndryshme. Më 1975 u emërua koreograf dhe udhëheqës artistik i Ansambllit “Shota” në Prishtinë. Arriti rezultate në kultivimin e valleve folklorike të traditës. Më 1986 në Festivalin Ndërkombëtar në Dizhon të Francës, në konkurrencën e mbi 120 vendeve të botës, “Shota” me koreografinë e tij “Dasma e Opojës” fitoi medaljen e argjendtë (vendi II), që konsiderohet ndër sukseset më të mëdha të Ansambllit ndër vite. Më 1986 botoi monografinë “Valle tradicionale të Opojës”. Ka realizuar mbi 20 koreografi me ansamble profesionale e amatore. Mori pjesë si interpret edhe në Festivalin “Akordet e Kosovës”. Më 1979 mori çmimin e jurisë profesionale me këngën “Mëma” në frymën popullore. Jeton në Gjenvë të Zvicrës, ku punon në kultivimin e traditës së valles, kryesisht me fëmijë shqiptarë, duke themeluar Ansambllin “Gëzuar”. Në 50-vjetorin e “Shotës” realizoi programin festif “Peizazh koreografik - Kosova ime”. (Sami Piraj)

BERISHA Xhevat (1957-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Sllatinë të Madhe, Fushë-Kosovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, kurse atë të mesëm në Prishtinë. Studimet i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimit të Universitetit të Zagrebit. Temën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së (2005). Puno si mësimpldhënës në shkollën e mesme teknike „19 Nëntori” të Prishtinës dhe në Termocentralin “Kosova A” në Obiliq. Në vitin 1984 u zgjodh asistent dhe më 2011 profesor i asociuar për lëndët burimet e energjisë, stabilimentet termoenergjetike,

termoelasticiteti, kaldajat energjetike të avullit dhe centralet bërthamore. Është autor i një sërë punimesh shkencore të botuara në revista të ndryshme dhe është pjesëmarrës në konferenca shkencore ndërkombëtare. Është bartës i shumë projekteve profesionale dhe ekspertizave teknike. Është certifikuar për projektimin dhe menaxhimin e energjisë termike, për auditor energjetik për objekte banimi dhe ato industriale etj. (Xhemajl Fejzullahu).

BERISHA Xhevat (1961-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Lez të komunës së Prizrenit. Pas mbarimit të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prizren punoi si mësues në shkollën fillore në fshatin Arbëri, deri në fillim të luftës. Në demonstratat dhe protestat e vitit 1989 u plagos nga forcat policore serbe. Me fillimin e luftës u përfshi në radhët e UÇK-së, në njësitin gueril "Petriti". Mori pjesë në aksionet për sjelljen e armëve nga Shqipëria. Më 10 qershor 1998 u emërua përgjegjës për zbulim dhe kundërzbulim. Mori pjesë në shumë aksione luftarake në zonën e Pashtrikut. Më 16 korrik 1998 mori pjesë edhe në betejën në lagjen "Tusus" të Prizrenit. Më 1 shtator të vitit 1998, në betejën në fshatin Lez të Prizrenit, Xh. Berisha ra së bashku me 13 pjesëtarë të UÇK-së, bashkëluftëtarë të tij. Në qendër të Prizrenit është ngritur shtatorja e Xh. Berishës. (Bedri Muhadri)

BERISHA Ymer (1912-1946). Luftëtar për çlirim kombëtar të Kosovës, veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Lindi në Gjurgjevik të Madh të Klinës. Në vitin 1924 emigroi në Shqipëri, ku u regjistrua në Normalen e Elbasanit. Në Romë kreu akademinë ushtarake dhe studimet për histori-geografi. Pas kthimit nga Italia, punoi si mësimsdhënës në disa fshatra të Shqipërisë. Në vitin 1941 u kthye në Kosovë dhe filloi punën si mësimsdhënës në Normalen "Sami Frashëri" në Prishtinë. Në vitin 1945, pas thyerjes së rezistencës në Drenicë, ndihmoi formimin e Komitetit Nacional-Demokratik Shqiptar me seli në Prizren, të udhëhequr nga Halim Spahiu. Ishte udhëheqës i luftës guerile. Në Kuvendin e Dobërdolit emërohet në krye të udhëheqjes politike. Në tetor të vitit 1945 i shkroi një letër gjeneralit Hadson, shefit të misionit

anglez në Tiranë, në të cilën e informoi mbi gjendjen në Kosovë. Si udhëheqës i Komitetit "Besa Kombëtare" zhvilloi aktivitetet të dëndur. Kishte rrjet të zhvilluar lidhjesh si brenda dhe jashtë vendit, përfshirë gjeneralin Hadson. Në pranverën e vitit 1946 mori pjesë në një tubim në Malësi të Gjakovës, në Shqipëri. U vra nga forcat komuniste më 11 korrik 1946 në Hereq të Gjakovës. (Lush Culaj)

BERISHA Zija (1931- 1996). Aktor. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Ndoqi studimet për gjuhë shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Në vitin 1952 u punësua si aktor në Teatrin e Kombësive në Shkup, ku debutoi në shfaqjen "Nuk martohem me parë" (1952). Disa nga shfaqjet, në të cilat realizoi role me rëndësi janë: "Besa", "Miu në xhep", "Familja e peshkatarit", "E ikura", "Bashkëshortët" etj. Realizoi role edhe në shfaqjet: "Mbreti Lir", "Romeo e Zhulieta" etj. Luajti rreth 40 vjet në skenën e Teatrit të Kombësive. Luajti edhe në filma artistikë, si: "Uka i Bjeshkëve të Nemuna", "Proka" etj. Interpretoi role edhe në shumë radiodrama. Për punën në teatër u vlerësua më një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh. Shkroi drama për fëmijë, të cilat i përmbloodhi në librin "Pjesë teatrale për fëmijë" (1972), si dhe dramat "Kurrë s'është vonë" (1974) dhe "Maturantët" (1976), të cilat i inskenoi në Teatrin e Kombësive në Shkup. (Emin Emini)

BERISHA-CANI Alida (1962-). Gazetare. Lindi në Beograd, ku kreu gjimnazin dhe Fakultetin Filologjik në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Nga viti 1985 deri më 1999 punoi korrespondente e së përditshmes "Rilindja", e pastaj korrespondente e gazetës "Bujku" nga Beogradi. Ishte po ashtu korrespondente e seksionit shqip të Radios BBC dhe "Europa e lirë" nga Beogradi. Bashkëpunoi edhe me revistat "Fjala", "Kosovarja", "Dita" dhe me mediet e tjera nga Kosova dhe Shqipëria. Pas luftës në Kosovë u largua nga Beogradi dhe jeton në Gjermani. Nga viti 1999 deri 2011 ka punuar si korrespondente e BBC në shqip nga Gjermania. Bashkëpunon me disa media gjermane dhe punon si përkthyes. Jeton në Bon të Gjermanisë. (Rahman Paçarizi)

BERISHAJ Anton (1965-). Studiues i letërsisë, mësimsdhënës universiteti. Lindi në Podgoricë,

Mal të Zi. Kreu shkollimin e mesëm në Tuz dhe letërsinë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Kreu studimet pasuniversitare të letërsisë dhe u doktorua për poetikën e letërsisë së vjetër shqipe (2009). Ka filluar punën si asistent në departamentin e letërsisë shqipe dhe nga viti 2002 është ligjërues për lëndën letërsi e vjetër shqipe. Ka botuar librin me poezi “Lule mëngjesi” (Podgoricë, 1986) dhe më pas librat studimorë “Retorika dhe letërsia” (2005) dhe “Letërsia performative” (2010), si dhe një numër studimesh në revistat e periodikun e vendit. Ka fituar çmime letrare. Disa vite ishte sekretar shkencor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. (Zejnullah Rrahmani)

BERISHAJ Anton Kolë (1954-). Sociolog, profesor universitar, akademik. Lindi në Priftën të Malësisë, Tuz, në Mal të Zi. Shkollën fillore e kreu në Tuz, gjimnazin në Ulqin, ndërsa u



ANTON KOLË
BERISHAJ

diplomua në degën e filozofisë dhe të sociologjisë të Universitetit të Prishtinës. Karrierën akademike e filloi në vitin shkollor 1980/81, në degën e filozofisë dhe të sociologjisë. Në vitin 1987 mbaroi studimet pasuniversitare në katedrën e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa më 1997 po ashtu në Universitetin e Zagrebit mbrojti temën e doktoratës. Në vitin 1992 u zgjodh të hapte zyrën e Fondit për Shoqëri të Hapur për Kosovë, të njohur si “Fondacioni Soros”, të cilën, si koordinator, e udhëhoqi deri më 1999. Pas luftës (2000-2002), krahas angazhimit mësimor në Universitetin e Prishtinës, u emërua menaxher lokal për trajtimin psikosocial të traumave, të financuar nga IOM-i. Ka ushtruar funksione dhe ka kryer detyra të ndryshme në Fakultetin Filozofik dhe në strukturat udhëheqëse të Universitetit të Prishtinës, përfshirë edhe funksionin e ushtruesit të detyrës të rektorit të Universitetit të Prishtinës (mars-shtator 2014). Më 2012 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës, ndërsa më 2016 anëtar i rregullt. Është autor i disa librave studimorë dhe monografive: “Shndërrimi i etnisë” (1998), “Në një cep të Ilirisë. Monografia e shqiptarëve në Mal të Zi”. (Visconsin, SHBA,

2007), “Filantropia në Kosovë” (2010), “Religjioni dhe politika në Kosovë” (2014), “Shoqëria pa shtet, studim socioantropologjik” (2014). Është bashkautor i dy librave shkollorë për sociologji dhe i një numri të teksteve shkencore të botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Nita Luci)

BERISHAJ Martin (1963-). Politolog dhe antropolog. Lindi në Tuz, në Mal të Zi. Pas mbarimit të shkollës fillore dhe gjimnazit në Tuz, studimet i vazhdoi në Universitetin e



MARTIN BERISHAJ

Lubjanës, në Fakultetin e Shkencave Politike. Gjatë studimeve ishte kryeredaktor i revistës së fakultetit “Razmerja” dhe botoi shkrime në revistat opozitare të kohës “Mladina”, “Teleks” dhe “Tribuna”. Tema e tij e diplomës “Karakter i ndërkombëtar i Lidhjes së Prizrenit” mori çmimin “Preshern” dhe u botua në gjuhën sllovene me titull “Rëndësia ndërkombëtare e Lidhjes së Prizrenit”. Pas mbarimit të studimeve u emërua hulumtues i ri dhe asistent në Fakultetin e Shkencave Politike po në këtë universitet. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Institutin e Studimeve Humanitare në Lubjanë, pastaj në Zagreb, Londër dhe Grac (1991), ndërsa studimet e doktoratës i kreu në Lubjanë, Vjenë, Zagreb, dhe Londër (2002). Më 2004 nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Sllovenisë u botua disertacioni i tij “Konteksti sociokulturor i familjes shqiptare”, me titull “Forca e fshehur e besës”. Udhëheq Institutin për Studime Shqiptare “Albanica” në Lubjanë. Është autor i artikujve të shumtë të botuar në revista dhe gjuhë të ndryshme dhe bashkautor i disa botimeve. (2011). (Gëzim Selaci)

BERISHA-LATIFI Nafije (1950-). Gazetare. Lindi në Dubravë të Kaçanikut. Shkollën fillore dhe Normalen i kreu në Ferizaj, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Filloi punën gazetare në revistën studentore “Bota e re”, ndërsa vazhdoi në revistën “Zëri i rinisë”. Nga viti 1976 ishte redaktore në revistën për femra dhe familje “Kosovarja”, më pas sekretare e Konferencës për Aktivitet Shoqëror të Grave të Kosovës (1986-1989) dhe redaktore në revistën arsimore “Shkëndija”. Në vitet 2000-

2004 botoi revistën për të rinj “Reze”, ndërsa në vitin 2005 themeloi Qendrën kosovare për luftimin e kancerit të gjirit “Jeta/Vita”. Është bashkëthemeluese e Iniciativës Ballkanike për Kancerin e Gjirit. Për angazhimet e saj në këtë fushë u nderua me çmime profesionale dhe mirënjohje shoqërore. (Shefqet Rexhepi)

BERJASHI Ibrahim (1948-). Publicist, shkrimtar. Lindi në Ostros (Krajë) të komunës së Tivarit, në Mal të Zi. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën Normale në Ferizaj, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Ishte korrespondent i “Rilindjes” nga Mali i Zi (1975 – 2002) dhe më pas i gazetës “Bota sot”. Botoi poezi për të rritur dhe poezi e tregime për fëmijë. Shkrimet letrare i botoi në gazeta dhe revista dhe në përmbledhje të veçanta: “Lule prej guri”(1980), “E tej Malësi e det”(1984), “Orët e vetmisë” (1996), “Gati u harruem” (2013) si dhe librat për fëmijë: “Veloret e bardha” (1985), “Lundra e humbur” (1988) dhe “Floçka e liqenit” (2006). Krijimtaria e tij letrare është përfshirë në tekste shkollore në Mal të Zi, në përzgjedhje të autorëve shqiptarë në gjuhën shqipe dhe malazeze. Ishte njëri nga themeluesit e shoqatës “Art Club” (1990) në Ulqin dhe pjesëmarrës në organizime të shumta letrare dhe kulturore të shqiptarëve në Mal të Zi. (Haxhi Shabani)

BERZHESHTA Halit (1840-1909). Farmacist, atdhetar. Lindi në Berzhesh të (Shqipëri), kreu gjimnazin në Stamboll dhe u diplomua për farmaci. Është farmacisti i parë më origjinë shqiptarë. Ishte drejtor i spitalit ushtarak turk në Manastir e Selanik, me gradën kolonel. Punoi si farmacist në disa vise të vilajeteve shqiptare. Në Janinë u njoh me vëllezërit Frashëri dhe bashkëpunoi për një kohë të gjatë me Naimin. U bë një nga propagandistët e ideve kombëtare. Në vitet ‘90 të shek. XIX u transferua në Manastir. Përkrahu veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Pejës. Së bashku me Bajo Topullin dhe atdhetarë të tjerë mori pjesë në ngritjen e Komitetit “Për Lirinë e Shqipërisë” në Manastir më 1905 dhe u bë një nga udhëheqësit e tij kryesorë. Për këtë veprimtari më 1907 u dënua me vdekje nga gjykata ushtarake turke. Për shkak të protestave të atdhetarëve shqiptarë, dënimi u kthye në internim të përgjithshëm në Bejrut. U kthye në Shqipëri pas shpalljes së Kushtetutës më 1908. Vdiq në Selanik. (Sherif Hoxha)

BESA. Fjala e nderit ose zotimi i pathyeshëm, besa, është element me rëndësi të posaçme në të drejtën zakonore shqiptare, si dhe përgjithësisht në jetën shoqërore. Ka ardhur si pasojë e kushteve shoqërore në të kaluarën. Në mungesë të pushtetit të organizuar dhe ligjeve pozitive, është sforcuar dhe glorifikuar si vlerë në tërë hapësirat shqiptare, pra edhe në Kosovë. Sipas Kanunit, vrasësi (dorasi) ka të drejtë që me anë të miqve të tij të kërkojë besë nga familja e të vvarit, të kërkojë leje që për një kohë të dalë lirisht, pa frikë se do të zbatohet gjakmarrja ndaj tij, ose ndaj pjesëtarëve të familjes së tij. Besa në rrethanat e gjakmarrjes ka pasur edhe rëndësi ekonomike, sepse pjesëtarët e familjes së dorasit kanë guxuar të dalin e të punojnë arat, nëse ua kanë dhënë besën, përndryshe fusha mbetet e djerrë, ose të lashtat të pa mbledhura. Disa fise ose bajraqe lidhnin besën që kishte të bëjë me bagëtinë dhe barinjët, në mënyrë që, me rastin e kalimit nëpër terrenin e fisit tjetër të mos u ngajë asgjë e ligë. Ndonëse më herët për shqiptarin patriarkal besa kishte domethënien e nderit e të burrërisë, si edhe të një faktori të fuqishëm në luftën çlirimtare kundër pushtuesve të ndryshëm, me kalimin e kohës ndryshuan edhe shprehitë, zakonet e botëkuptimit. Sot për shqiptarët besa është element i traditës, por në disa zona vazhdon të jetojë ende. Me funksionalizimin e institucioneve të shtetit, besa gjithnjë e më tepër po zëvendësohet me akte të ligjeve pozitive. (Bashkim Lajçi)

BESËT. Fis thrakas, i cili jetonte në territorin që shpinte nga Mezia në drejtim të malit Rodop të Thrakës Jugore. Sipas Strabonit, besët jetonin në pjesën lindore të dardanëve. Janë përmendur shpesh si banorë rreth malit Haem, i cili e ndante Mezinë nga Thracia dhe nga mali i Rodopit. (Emine Kalaja-Hajdari)

BESIANA. Shih: **PODUJEVA**.

BESIMET PAGANE. Besim i popujve parahistorikë në fuqinë e fenomeneve natyrore dhe, më pas, në shumë hyj antropomorfë. Dëshmitë më të hershme kushtuar perëndive paganë në epokën e neolitit e të eneolitit në Kosovë janë figurina antropomorfe të punuara në botë të pjekur (Glladnicë te Graçanica, Runik te Skënderaj, Vlashnjë te Prizreni, Varosh te Ferizaj, Tjerrtore, Barilevë e Bardhosh te Prishtina) dhe në mesin e tyre më e njohura është

“Hyjnesha e Prishtinës” (Hyjnesha në fron). Dy kultet e dëshmuara nga parahistoria deri në antikën e vonë në territoret ilire janë Kulti i Diellit, me pozitë qendrore të ilirët e veriut dhe Kulti i Gjarprit, më i theksuar të ilirët e jugut. Kulti i gjarprit paraqitet në forma të ndryshme dhe njihet si kulti i çiftit Drako dhe Drakena, i dëshmuar vetëm në Sopot të Maqedonisë. Besimet pagane ilire më së shumti janë dokumentuar nga mbishkrimet epigrafike të periudhës romake dhe në Kosovë gjenden emrat e hyjnive vendore, si Hyjnesha Dardane, hy i diellit apo Andini, mbrojtës i familjes dhe i vatrës familjare. U paraqitën dhe hyj të romanizuar, të importuar nga legjionarët e ushtrisë romake. Në protohistorinë dhe antikën e Kosovës, si dhe gjetiu, ishte i përhapur dhe mitraizmi, kulti i Dionisit, kulti i Orfeut, më vonë kulti i Eskulapit dhe i Higisë. Një hyj tjetër që dëshmohet në mbishkrimet votive është ai i Deus Tatto-s, i cili nderohej kryesisht nga fisi ilir i dalmatëve. (Arianit Buçinca)

BESIMET POPULLORE. Shprehje të kulturës shpirtërore dhe tërësi veprimesh që bazohen në besimin të fuqitë e mbinatyrshme, të cilat sjellin shëndet, mbarësi, mbrojtje nga të ligat dhe fatkeqësitë. Në Kosovë ende gjallojnë besime dhe rite popullore, si dhe besime fetare. Veçohen besimet pagane në diell, në zjarr, në hënë, në ujë, në shi dhe në breshër. Ekzistojnë disa burime, jaze, puse, kroje dhe gurë që konsiderohen vende kulturi me aftësi shëruese. Disa gurë të mëdhenj dhe të vrimuar në fshatrat Suzi afër Prizrenit dhe në Bogë të Rugovës i vizitojnë gratë që nuk mund të lindin dhe fëmijët ose personat me probleme në të folur. Besimi në kultin e gjarprit, si mbrojtës i shtëpisë dhe simbol i begatisë, ruhet në shumë vise të Kosovës. Shqiponja nderohet si simbol totemik. Besimet popullore lidhen edhe me kalin, kaun, gjelin, pulën, bretkosën, ujkun, zogjtë, palloin. Populli i Kosovës besonte në magji dhe në syrin e keq, që sjellin sëmundje dhe të liga të tjera. Për mënjanimin e tyre përdorshin hajmalitë, shuhen gaca dhe vizitohen tyrbet e shenjtorëve. Ekziston një numër i konsiderueshëm i tyrbeve, rreth të cilëve njerëzit bëjnë lutje, hedhin monedha dhe nderojnë qirinj. Nëse u plotësohet dëshira, ata ziejnë oriz apo hallvë ose therin kurbane. Populli beson në “fatoret”, që janë tri zana, të cilat caktojnë fatin e foshnjës. Zanat dhe orët e maleve konsiderohen si hyjni mbrojtëse të

njerëzve, të kafshëve, të familjes dhe të shoqërisë. Dragoi është figurë e cila simbolizon të mirën dhe lufton me kuçedrën, e cila simbolizon të keqen. Nga ritet dhe festat popullore të motmotit dhe festat me karakter fetar shquhen: Krishtlindjet, Viti i Ri, Dita e Verës, Dita e Jeremisë, Pashkët, Shëngjergji, Shëmitri, Shën Kolli, Dita e Vangjelizmoit, riti i ndjelljes së shiut dhe ndaljes së breshrit etj. Në disa nga këto festa dhe rite vërehet ndërthurja e elementeve pagane me ato të krishtera. Nata e buzmit (24 dhjetor) përcillet me rite pagane rreth kulteve të diellit, të bimësisë dhe të të parëve të familjes. Riti kryesor është sjellja në shtëpi e trungut ritual, “buzmit” nga i zoti i shtëpisë. Buzmi vendoset në zjarr, ndërkaq rreth tij mblidhen anëtarët e familjes, të cilët bëjnë veprime rituale për mirëqenie dhe shtim të prodhimtarisë dhe të bagëtisë. Zakonet rreth buzmit i hasim kryesisht te popullsia e krishterë dhe aty-këtu te popullsia myslimane e Kosovës. Dita e Verës festohet më 13 dhe 14 mars, në shenjë të ringjalljes së natyrës me ardhjen e pranverës. Në rajonin e Opojës, në këtë ditë të rinjtë nderojnë zjarre rituale në maje të maleve dhe vendosin në dyer të shtëpive degë të dëllinjave. Ndërkaq, në fshatrat e Opojës dhe të Gorës, në ditën e Jeremisë (13 maj), vajzat dhe gratë sillnin në shtëpi dheun për të bërë çerepë. Pashkët festohen që nga kohët e paganizmit, si festë e ringjalljes së natyrës në pranverë. Ritualu bëhet për të ndjellë pëlleshmëri në bujqësi dhe blegtori dhe për mirëqenien e familjes. Shiu ndillet duke mbaruar “dordolecin”, një vajzë e veshur me gjelbërime, e cila spërkatet me ujë nga gratë, me besim se ky veprim magjik do të sjellë shiun.

Sot disa besime, festa dhe rite popullore janë ende gjallë dhe përdoren në disa vise të Kosovës, ndërsa një numër syresh tashmë janë zhdukur. (Shpresa Siqeca)

BETEJA E CARRALEVËS (1910). Betejë e kryengritjes së vilajetit të Kosovës të vitit 1910. U zhvillua në grykë të Carralevës, në rrugën ndërmjet Ferizajt dhe Prizrenit, midis forcave osmane nën komandën e ministrit të Luftës, Mahmut Shefqet Pashës e Shefqet Turgut Pashës dhe kryengritësve shqiptarë, të udhëhequr nga Isa Boletini. Beteja u zhvillua në Shtime, Jezerc dhe Carralevë. Numri i forcave osmane arrinte rreth 30,000 ushtarë, ndërsa forcat kryengritëse shqiptare arrinin deri në 3,500 veta. Sulmet e përsëritura të ushtrisë osmane, e cila ishte

ndarë në tri kolona jo vetëm që nuk kursyen fshatrat e pambrojtura si dhe pozicionet e kryengritësve, por e shtynë sektorin e mbrojtjes së kryengritësve që më 7 maj të zhvendosej në drejtim të Jezercit. Mësuesit dhe klerikët serbë të zonës u vunë në shërbim të ushtrisë osmane. Forcat osmane arritën të rrethonin kryengritësit shqiptarë në të gjitha anët, duke i bombarduar ata me artileri të rëndë. Kryengritësit shqiptarë u bënë ballë disa ditë sulmeve të ushtrisë osmane në grykën e Carralevës. Pas një lufte që zgjati gjatë tërë ditës së 10 majit, kryengritësit arritën që në orët e vona të mbrëmjes së 11 majit 1910 të çanin rrethimin dhe të tërhiqeshin dhe të kalonin në Drenicë, bashkë me shokët e plagosur si dhe drejtuesin e tyre Isa Boletini, që po ashtu ishte i plagosur. Beteja e Carralevës i dha përparësi ushtrisë osmane të shuante kryengritjen e vilajetit të Kosovës të vitit 1910. (Fitim Rifati)

BETEJA E DYTË E KOSOVËS (1448). Beteja u zhvillua më 17-19 tetor 1448, midis aleancës së krishterë, të udhëhequr nga Huniadi dhe ushtrisë osmane në krye me sulltan Muratin II. Arbërorët në krye me Skënderbeun, u përfshinë në aleancën e krishterë. Thirrjes së Huniadit për këtë ballafaqim me osmanët nuk iu përgjigj Republika e Venedikut, me pretekst se kishte andralla me Skënderbeun. Nuk iu përgjigj as Alfonsi V, papa Nikolla V, despoti i Rashës, Gjuragj Brankoviçi dhe as Republika e Raguzës.

Në verë të vitit 1448, pasi kishte tubuar reparte hungareze, polake, rumune, çeke etj., Huniadi kaloi Danubin dhe, duke i shkretuar zotërimet e despotit Gjuragj, doli në Krushevc dhe prej këtej arriti në Kosovë. Në anë tjetër, Murati II, pasi ishte informuar nga despoti Brankoviç, kishte ndërprerë ekspeditën e përgatitur kundër Arbërisë dhe në Sofje kishte tubuar rreth vetes të gjitha repartet, të cilat numëronin 50-60 mijë ushtarë. Repartet e aleancës së krishterë, sipas burimeve perëndimore arrinin 22-72 mijë ushtarë, ndërsa sipas burimeve osmane 24 mijë. Lufta triditëshe mbaroi me disfatën e ushtrisë së krishterë.

Premtimet që i kishte dhënë Skënderbeu për t'u angazhuar në anën e aleancës së krishterë e kishin trimëruar Huniadin që të nxitonte për t'u ndeshur me osmanët. Por burimet e kohës ofrojnë hollësi për vonimin e Skënderbeut për t'u bashkuar me trupat hungareze. Shkak

kryesor i vonimit të Skënderbeut ishin pengesat e despotit Brankoviç, aleat i dhëndrit Muratit II, që ia mbylli këtij të gjitha rrugët dhe shtigjet nga mund të kalonte. Shumica e burimeve, duke arsyetuar vonesën e Skënderbeut, nxorën në shesh dhe pashkathtësinë e Huniadit, i cili nuk ishte dashur të pranonte betejën para ardhjes së Skënderbeut në Kosovë. Një pjesë e trupave, pasi kishte marrë rrugë për në jug, jo larg Fushës së Kosovës, u takua më Skënderbeun, që ishte nisur t'i bashkohej Huniadit. Pjesa tjetër në malet e Çiçavicës, në afërsi të Vuçitërnës, u takua me duk Bogdanin, një stërgjiysh i Pjetër Bogdanit. Tërheqin vëmendjen sidomos burimet që dolën pas betejës, të cilat, së bashku me epikën popullore, kanë ngatërruar personazhet e Betejës së Parë me ato të Betejës së Dytë të Kosovës. (Jahja Drançolli)

BETEJA E GLOGJANIT (24 mars 1998). Beteja e parë frontale e zhvilluar ndërmjet forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në rajonin e Dukagjinit. Pas sulmit kundër familjes Jashari në Prekaz, sulmi frontal i radhës u bë mbi familjen e Hilmi Haradinajt, në Glogjan të Deçanit, djemtë e të cilit (Ramushi, Luani, Shkëlzeni e Dauti) ishin ndër themeluesit e UÇK-së. Para agimit të 24 marsit 1998, qindra forca të armatosura rrethuan Glogjanin. Sulmi i parë mbi familjen Haradinaj filloi rreth orës 10:45, me çrast u vra një polic serb dhe u plagosën dy të tjerë. Pas pak rrethi i fshatit u ngushtua edhe më. Pas tërheqjes nga shtëpia e Haradinajve dhe pozicionimit në brendi të fshatit të luftëtarëve të UÇK-së, luftimet më të rrepta për disa orë radhazi u zhvilluan tek Ura e Zallit, ku luftëtarët e Glogjanit ishin pozicionuar në kullat e afërme. Në këtë sulm forcat serbe përdorën gjithë makinerinë e blinduar, armatimin e rëndë dhe helikopterët. Forcat serbe kishin zënë peng rreth 130 nxënës të shkollës fillore "Hasan Prishtina" të Glogjanit, përfshirë edhe 13 banorë të fshatit, të cilët i përdorën si mburojë për të lëvizur nëpër fshat. Humbjet e forcave policore serbe ishin të mëdha. Në këtë luftë, që zgjati mbi dhjetë orë, u vranë mbi 22 pjesëtarë të forcave serbe dhe u plagosën shumë të tjerë, si dhe u shkatërruan 2 autobllinda. Në këtë betejë luftoi tërë familja Haradinaj dhe bashkëluftëtarë të tjerë. Ranë dëshmorë tre pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në përpjekje për t'i liruar nxënësit e zënë peng nga forcat serbe, ndërsa u plagos rëndë edhe Ramush Haradinaj. Beteja

e Glogjanit pati rol vendimtar në zgjerimin e luftës dhe shtimin e radhëve të lirisë jo vetëm në Dukagjin, por edhe në mbarë Kosovën. Pas vitit 1999, 24 marsi tradicionalisht shënohet si dita e fillimit të luftës frontale në Zonën Operative të Dukagjinit, e njohur si Epopeja e Dukagjinit. (Fetnete Ramosaj)

BETEJA E KAÇANIKUT (1690). Betejë e zhvilluar ndërmjet ushtrisë osmane dhe ushtrisë austriake në kohën e luftërave austro-osmane 1683-1699. Pas konsolidimit të ushtrisë osmane, fitoret e mëhershme të austriakëve filluan të shuheshin një nga një. Njëpërmjet ushtrisë tatarë të Krimesë, osmanët përparuan në të gjitha anët e Kosovës e Maqedonisë, me ç'rast u shua edhe kryengritja e Karposhit. Në duart e austriakëve në Kosovë mbeti vetëm fortesa e Kaçanikut. Në Betejën e Kaçanikut, zhvilluar më 2 janar 1690, ushtria austriake, nën drejtimin e kolonelit Shtraser, pësoi disfatë të thellë, sepse në momentin vendimtar, shqiptarët, për shkak të sjelljeve të vrazhda të Shtraserit, kaluan në anën osmane. Në fushë të betejës, pos shumë kontëve dhe princërve, viktimë ra edhe vetë Shtraseri. Pas këtij triumfi osman, mbrojtësit e kështjellës së Kaçanikut iu dorëzuan fituesve. Austriakët dhe hungarezët, si robër luftime, u lejuan të ktheheshin në shtetet e tyre, ndërkaq një pjesë e kryengritësve vendas e pësoi me jetë. Meqenëse ushtria osmane pothuaj në të njëjtën kohë e kishte futur në dorë Shkupin, Novobërdën dhe Prishtinën, ushtria austriake u detyrua ta lëshonte përfundimisht Kosovën dhe Maqedoninë. (Gazmend Rizaj)

BETEJA E KAÇANIKUT (1910). Betejë e zhvilluar ndërmjet kryengritësve shqiptarë nën udhëheqjen e Idriz Seferit dhe të forcave osmane, të komanduara nga gjenerali Shefqet Turgut Pasha. Forcat osmane, të përbëra nga 17,000 ushtarë, me 64 topa e 120 mitraloza, filluan operacionin për marrjen e Grykës së Kaçanikut. Përballë tyre qëndronin rreth 4,000 luftëtarët e Idriz Seferit. Beteja filloi më 30 prill 1910. Forcat osmane u hodhën në sulm nga Ferizaj dhe nga Shkupi. Për dy ditë rresht u zhvilluan luftime të ashpra. Më 1 maj kryengritësit u detyruan ta lënë Grykën e Kaçanikut dhe e vazhduan qëndresën në Anamoravë, Karadak, Preshevë, Gjilan, Bujanoc e Kumanovë, deri më 6 maj 1910. Gryka e Kaçanikut, për qëndresën dhe strategjinë e ndjekur, u quajt nga bashkëkohësit "Termopilet shqiptare". (Isa Bicaj)

BETEJA E KAÇANOLLIT (15-18 shtator 1998). Beteja e parë frontale e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Zonën e Llapit, kundër forcave ushtarake dhe policore serbe. Më 15 shtator 1998 forca të shumta serbe ndërmorën një ofensivë të gjerë në veriperëndim të zonës së Llapit dhe të rajonit të Shalës, me qëllim të shpërbërjes së UÇK-së. Mbi 24 mijë forca serbe sulmuan për tri ditë me radhë pozicionet e UÇK-së (më 15, 16 dhe 17 shtator), nga drejtimi i Podujevës, Mitrovicës dhe Vushtrrisë, në Dobratin dhe në Qafën e Kaçanollit, aty ku kufizohen Llapi me Shalën. Forcat serbe kishin angazhuar artileri të rëndë dhe mjete të shumta të blinduara. Luftimet u shtrinë në zonën e fshatrave Dobratin, Bradash, Potok si dhe në fshatrat e zonës së Shalës: Kaçanoll, Bajgorë dhe Bare. Vija e frontit të kësaj beteje kishte një gjatësi prej 30 km, ku u mbrojtën pozicionet e UÇK-së. Luftimet u zhvilluan kryesisht në afërsi. Nga radhët e UÇK-së u vranë 8 luftëtarë, ndërsa pas betejës, në tërheqje e sipër, forcat serbe masakruan dhe vranë shumë civilë të pambrojtur në fshatrat e zonës së luftimeve. Pas kësaj beteje, forcat e UÇK-së u riorganizuan dhe e shtrinë kontrollin e tyre në tërë pjesën perëndimore të magjistrales Prishtinë-Podujevë-Kërpimëh, duke vendosur komandën e Zonës Operative të Llapit në fshatin Llapashticë të Epërme. (Ismet Cakiqi)

BETEJA E KLYSYRËS (26 nëntor 1997). Beteja e parë frontale ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave ushtarake-policore serbe, që u zhvillua më 26 nëntor 1997, në vendin e quajtur Klysyre, mes fshatit Llaushë dhe Rezallës së Re të komunës së Skënderajt. Njësitet e UÇK-së të Drenicës, nën udhëheqjen e komandantit Adem Jashari organizuan mbrojtjen ballore, duke zbatuar taktikën e befasisë me prita në një hapësirë të madhe. Kjo betejë zgjati rreth 2-3 orë. Forcat serbe pësuan humbje në teknikë luftarake, pati të vranë dhe të plagosur. Në këtë betejë morën pjesë: Abedin Rexha, Mujë Krasniqi, Sylejman Selimi, Jetulla Geci, Sabit Geci, Sejdi Geci, Zenun Kodra, Xhevahir Geci, Brahim Binaku, Ilaz Dërguti, Avni Haxha etj. Kjo betejë ishte një fitore e madhe për UÇK-në kundër forcave serbe, të cilat gjatë zbrapsjes për në Skënderaj vranë mësuesin Halit Geci, gjatë varrimit të të cilit për herë të parë u shfaq publikisht UÇK-ja. (Sabit Sylja)

BETEJA E KOSOVËS (1389). Ngjarje historike mesjetare e përfolur dhe e mitizuar. Me kohë fitoi atributet e disfatës më të madhe serbe, edhe pse sot në historiografi hidhen dyshime se ajo vërtet kishte qenë e tillë. Vështirësitë për të mësuar të vërtetën për këtë ngjarje paraqesin numri i kufizuar i burimeve të kohës dhe ngatërrimi i tyre me rrëfime legjendare.

Burimet dokumentare e identifikojnë ditën e Shën Vitos/Shën Vidit (15/28 qershor 1389) si datë të ballafaqimit ushtarak ndërmjet ushtrisë së "Koalicionit ballkanik" (rasianët, arbërorët boshnjakët, hungarezët, kroatët, vllehtë, çekët etj.), të udhëhequr nga princi Lazar Hrebelanoviç, që priste në Fushë-Kosovë, në vendin ku bëhen bashkë Llapi e Sitnica, për t'i bërë ballë ushtrisë osmane në krye me Sulltan Muratin I, me bijtë e tij, Bajazitin e Jakubin. Sipas legjendës, Murati I u vra gjatë ose pas betejës nga dora e një bujari, një ushtari të plagosur ose një dezertori të quajtur Milosh Kopiliq/Kobiliq/Obiliq. Princi Lazar u kap dhe më pas u ekzekutua. Informacionet mbi numrat e saktë dhe përbërjen e ushtrive përkatëse, apo viktimat, janë kontradiktore. Dihet vetëm se Bajaziti kishte pasuar të atin në fron, ndërsa Stefan Lazareviç, nën tutelën e nënës, Milica, kishte pranuar të paguante haraç dhe ishte betuar për besnikëri ndaj osmanëve.

Me kalimin e kohës Beteja e Kosovës vishet me të dhëna subjektive e të mitizuara. Dihet se beteja kishte qenë shumë e ashpër dhe kishte pasur humbje të mëdha nga të dyja anët. U vra si Lazari, ashtu edhe Murati I. Aty mbeti i vrarë edhe princi Theodori II Muzaka, zot i Beratit dhe i Myzeqesë. Çdo gjë tjetër është e pasigurt. Krahas toponimeve: *Campus Turdorum*, *Campus Merulae*, *Kosovo Polje*, *Sclavonia*, *Albaniae (d'Albanie)*, *Rasia*, që i referohen trevës ku është zhvilluar beteja, shpesh ndeshim edhe toponime antike të përdorura sipas modës humaniste e bizantine, si *Dardania* dhe *Mysia*. Të tilla njoftime ndeshim te humanistët Segoni, Beçikemi, Tubero etj.

Miti mbi Betejën e Kosovës është aktualizuar sidomos nga shek. XIX në shkrimtarinë serbe dhe jeton edhe sot si shprehje e nevojave të politikës së ditës. Si i tillë është krijuar dhe promovuar dhe miti politik për Kosovën, ku ngjarjet e së kaluarës "marrin kuptim të veçantë dhe rëndësi për të tashmen". (Jahja Drançolli)

BETEJA E KOSHARES (9 prill 1999-16 qershor 1999). Betejë e Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës (UÇK) me forcat ushtarake të Serbisë, në kufirin Kosovë-Shqipëri. Ishte njëra nga betejat më të mëdha dhe më të rëndësishme të UÇK-së. Shënoi sulmin e organizuar të njësiteve të UÇK-së kundër forcave ushtarake serbe. Sulmi frontal filloi më 9 prill 1999, pas konsultimeve të Shtabit të Brigadës 138 me Komandën e Zonës Operative të Dukagjinit dhe Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe në koordinim me bombardimet e NATO-s. Sulmi filloi nga territori i Shqipërisë, përgjatë vijës kufitare në rajonin e Koshares, komuna e Gjakovës. Udhëheqës i operacionit ishte Agim Ramadani, kryeshef i Shtabit të Brigadës 138, i cili udhëhoqi përgatitjen e planit luftarak. Më 10 prill u mor posta ushtarake jugosllave në Koshare. Në luftime morën pjesë ushtarët e batalionit të parë, ushtarët e policisë ushtarake dhe grupi i ndërhyrjes së shpejtë "Kobrat". Më 11 prill 1999 ishte planifikuar marrja e bazës së ushtrisë jugosllave në Koshare. Për këtë qëllim Agim Ramadani me një skuadër të batalionit të dytë dhe grupin "Kobrat" ishte nisur nga baza e Koshares në drejtim të vendit Rrasa e Koshares, ku duhej të takohej me Anton Çunin dhe njësitin e tij. Në këto luftime ra dëshmor Agim Ramadani në vijën e parë të frontit. Beteja vazhdoi edhe në ditët në vijim. Më 19 prill te Rrasa e Koshares forcat serbe sulmuan me këmbësori dhe me artilleri të rëndë. Aty ra dëshmor edhe Sali Çekaj, në vijën e parë të frontit. Luftimet e ashpra vazhduan pothuajse çdo ditë, deri në përfundim të luftës. Përveç pjesëmarrjes së qindra luftëtarëve vullnetarë nga të gjitha trojet shqiptare dhe diaspora, merrnin pjesë edhe vullnetarë të tjerë të kombeve të huaja. Kanë marrë pjesë edhe rreth 300 ushtarakë të Divizionit të Kukësit të Ushtrisë Shqiptare. Falë kësaj ndihme për herë të parë gjatë luftës në Kosovë nga ana e UÇK-së në frontin e Koshares janë përdorur topat e kalibrave të mëdha. Brigada 138, që tashmë kishte marrë emrin e komandantit të saj, ka meritën kryesore për thyerjen përfundimtare të kufirit Kosovë-Shqipëri dhe për fitoren në këtë betejë. Betejat më të rëndësishme u zhvilluan te Rrasa e Koshares, në Bjeshkët e Junikut, te Rrasa e Zogut, në Koshare, në Qafë të Morinës etj. Në këtë betejë kanë rënë 114 dëshmorë të kombit, ndërkaq janë plagosur 438 luftëtarë. (Faton Mehmetaj)

BETEJA E KULINËS (1912). Betejë e zhvilluar ndërmjet ushtrisë osmane dhe kryengritësve

shqiptarë në fushën e Llapit. Beteja u zhvillua më 11-12 korrik 1912, midis fshatrave Bërnice dhe Kulinë. Forcat qeveritare u nisën drejt kësaj zone nga dy drejtime, për t'i rrethuar forcat kryengritëse. Operacionet e ushtrisë osmane i organizonte Ismail Fadil Pasha, i cili u nis nga Prishtina më tetë batalione dhe zuri pozicionet në vijën Vranidoll-Teneshdoll-rrezë e Majacit. Kurse nga Vushtrria ishin nisur gjashtë batalione të tjera këmbësorie, të pajisura me artileri, duke kaluar nëpër Samadrexhë dhe Breznicë, me synim për të dalë në kodrat e Barilevës dhe Lupçit të Poshtëm. Plani i forcave osmane dështoi, sepse kryengritësit shqiptarë nga Vesekofci arritën në Lupç dhe krijuan një vijë të frontit kundër ushtrisë osmane. Në grykën e Kulinës kryengritësit luftuan për gjashtë orë në luftën e pabarabartë dhe të përgjakshme. Humbjet nga të dyja palët ishin me dhjetëra të vrarë. Lufta vazhdoi edhe më 13 dhe 14 korrik 1912, kurse ushtria osmane u detyrua të tërhiqej nga fusha e Llapit dhe u pozicionua në kodrat përreth Prishtinës. (Luan Tetaj)

BETEJA E LOXHËS (1998). Betejë e formacioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kundër trupave ushtarake dhe policore të Serbisë, e zhvilluar më 6 korrik 1998 në fshatin Loxhë afër Pejës. Fshati Loxhë kishte rëndësi të madhe strategjike pasi ishte urë lidhëse ndërmjet zonave të kontrolluara nga UÇK-ja dhe qytetit të Pejës. Dalja publike e njësiteve të UÇK-së në Loxhë e Raushiq të Pejës u vlerësua si sfidë e madhe për forcat serbe, meqë fshatrat gjendeshin në periferi të qytetit, afër bazës ushtarake serbe në Zagermë, në kufi me fshatin Gorazhdec, ku gjendeshin njësitet paramilitare serbe. Në këtë vijë të frontit (Loxhë-Raushiq) mbroheshin të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit, deri në Glllogjan. Ofensivës kundër fshatrave Loxhë e Raushiq i parapriu një incident i armatosur, që kishte ndodhur në afërsi të fshatit gjatë kohës kur Vojisllav Shesheli gjendej për vizitë në Pejë. Në atë përleshje kishte rënë dëshmor Tahir Shala nga Loxha. Më 6 korrik, që në orët e hershme të mëngjesit u sulmuan njëkohësisht fshatrat Loxhë e Raushiq nga forcat e ushtrisë, të policisë dhe të paramilitarëve serbë. Në këtë betejë morën pjesë luftëtarë të UÇK-së nga e gjithë Zona e Dukagjinit, të cilët kishin për më shumë se dy javë që kishin përforcuar pozicionet e tyre në Loxhë, sepse kishte

informacione se forcat serbe do të sulmonin në këtë pikë. Në këtë betejë morën pjesë edhe ish-oficerët e ushtrisë jugosllave të ardhur disa ditë më parë në Kosovë. Në këtë betejë forcat serbe pësuan humbje të mëdha dhe u detyruan të tërhiqen. As në ofensivën e dytë kundër Loxhës (më 11 korrik) forcat serbe nuk arritën të depërtonin në fshat. Ofensiva e tretë, e përmasave shumë më të mëdha, u ndërmor më 15 gusht. Fillimisht, në orët e hershme të mëngjesit u bombardua Loxha me katër aeroplanë luftarakë dhe gjashtë helikopterë. Një brigadë tankesh dhe autobлиндash mori pjesë në sulm, duke e mbajtur fshatin nën zjarr të pandërprerë të artilerisë dhe të forcave të këmbësorisë. Pothuajse tërë ditën njësitet e UÇK-së bënë rezistencë heroike, ndonëse luftimet ishin të përgjakshme dhe të pabarabarta. Gjatë tri ofensivave, nga UÇK-ja ranë shumë dëshmorë, përfshirë komandantin e vijës së frontit në Loxhë, Skënder Çekun, pastaj eprorë dhe aktivistë të tjerë, si dhe u plagosën shumë luftëtarë. (Faton Mehmetaj)

BETEJA E MARICËS (1371). Fitore e ushtrisë osmane kundër ushtrisë së bashkuar rasiane-serbe. Pas pushtimit të Galipolit (1354), osmanët vijuan sulmet në territoret e despotit Uglesha Mërnjavçeviç në Greqinë Verilindore (Traki), duke rrezikuar edhe trevat e Perandorisë Bizantine dhe të Bullgarisë. Beteja u zhvilluan më 1371 në fshatin Çernomen (sot Ormenio, në Greqi) pranë lumit Maricë. Në betejë, krahas Ugleshës e vëllaut të tij Vukashin që sundonin trevat jugore të Perandorisë së dikurshme të Dushanit, ishte edhe ushtria bullgare e bizantine. Këto forca, të cilat sipas kronistit bizantin Halkonkondilit arrinin rreth 70,000 ushtarë, sulmuan territorin e Perandorisë Osmane, plaçkitën e u kthyen në vend. Ushtria osmane, nën komandën Lala Shanit, shumëfish më e vogël në numër, përcolli lëvizjet e ushtrisë kundërshtarë nga malet e afërta dhe e sulmoi atë në orët e hershme të 26 shtatorit dhe e shpartalloi atë. Midis të vrarëve ishin edhe dy despotët serbë, Vukashini dhe Uglesha. Vukashinin e trashëgoi i biri, Marko Kraveviqi, një vasal osman në luftëra kundër popujve të krishterë të Ballkanit. Fitorja e Maricës u hapi rrugën osmanëve për sulme të tjera pushtuese ndaj Ballkanit dhe trevave arbërore, përfshirë edhe Kosovën dhe trevat përreth saj. (Ramiz Abdyli)

BETEJA E NIKOPOLIT (1396). Fitore e ushtrisë osmane mbi ushtrinë e koalicionit të krishterë europian. Beteja u zhvillua në Nikopojë të Bullgarisë, pranë një forte të rëndësishme osmane, në rrjedhën e poshtme të lumit Danub. Ajo përbënte një përpjekje të ushtrive të krishtera europiane për të parandaluar depërtimin osman drejt veriut. Ushtria osmane, nën udhëheqjen e sulltan Bajazitit I (1389-1402), e mbështetur edhe nga ushtria e vasalit rasian, Stefan Lazareviq (1402-1427) në njërin anë, dhe ushtrisë së perandorit të Perandorisë së Shenjtë Romake, Sigismund (1368-1437), Vllahisë, Francës, Anglisë, Gjermanisë, Burgundisë dhe Venedikut, në anën tjetër. Ushtria e krishterë u nis nga Budimi drejt rrjedhës së Danubit, por u dha pas plaçkës përgjatë rrugës. Sulltan Bajaziti I, pasi kuptoi synimin e tyre, u doli përpara në Nikopol, disa kilometra larg kështjellës së këtij qyteti. Forcat osmane përbëheshin prej 16,100 ushtarësh, prej të cilëve 5,000 ishin rasianë, ndërsa forcat e krishtera kishin rreth 16,000 kalorës. Në fushëbetejë ushtria e krishterë nuk pati koordinim të duhur, për çarsye pësoi disfatë të rëndë, duke humbur shumë ushtarë. Sigismundi ia doli të arratisë nga fushëbeteja dhe, me ndihmën e anijes venedikase, të arrinte në Raguzë (Dubrovnik). Osmanët me këtë fitore forcuan pozitat në Gadishullin Ballkanik. Ishte kjo përpjekja e fundit e rëndësishme e krishterëve europianë për të penguar depërtimin e mëtejshëm osman në Ballkan. (Ramiz Abdyli)

BETEJA E NOKSHIQIT (1879). Betejë për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë nga aneksimi malazez. U zhvillua ndërmjet ushtrisë së Malit të Zi dhe të forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ngurrimi i Fuqive të Mëdha dhe hezitimi i Portës së Lartë për të realizuar vendimet e Kongresit të Berlinit nxitën knjaz Nikollën që të urdhëronte forcat ushtarake malazeze të merrnin me luftë viset e premtuara të Plavës dhe të Gucisë. Forcat e Lidhjes prej rreth 2 mijë vullnetarësh komandoheshin nga Ali Pashë Gucia, Jakup Ferri, Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Filip Çeka, Jusuf Sokoli, Çel Shabani etj. Më 4 dhjetor 1879 ushtria malazeze, e përbërë prej rreth 4 mijë vetash, e komanduar nga Mark Milani, ndërmori një sulm të rrufeshëm në drejtim të Plavës. Luftimet më të ashpra u bënë

në luginën e Nokshiqit, ku u angazhuan forca të shumta të ushtrisë malazeze. Luftëtarët u përleshën aq ashpër me njëri-tjetrin, sa që të dy palët lanë mënjanë hutat dhe nxorën jataganët, duke u përleshur trup më trup. Përleshja vazhdoi disa orë me radhë. Forcat vullnetare të Lidhjes ndalën sulmin e ushtrisë malazeze dhe i shkaktuan asaj disfatë, duke e detyruar të tërhiqej brenda kufijve të Malit të Zi. Nga malazezët pati 300 të vrarë e të mbytur në lumë gjatë tërheqjes, ndërsa nga shqiptarët 300-400 veta. Në këto luftime u vra edhe një nga komandantët e shquar të ushtrisë së Lidhjes, Jakup Ferri. Disfata që pësoi ushtria malazeze në Nokshiq e cenoi rëndë prestigjin politik e moral të Malit të Zi. (Fitim Rifati)

BETEJA E PANTINËS (1168). Është fjala për grindjet brenda dinastisë rasiene nemanjide për pushtet, si dhe përfshirja e ushtrisë bizantine në këto grindje. Në vitin 1165, perandori bizantin Mihaili i Parë Komneni kishte zënë për rob Desën, një zhupan i Rashës, të cilin e kishte internuar në Konstandinipojë. Konflikti kishte filluar për shkak se Desa kishte bashkëpunuar me hungarezët kundër Perandorisë Bizantine. Atëbotë, perandori bizantin ia kishte ofruar pushtetin Tihomirit, vëlla më i vjetër i Stefan Nemanjes, i cili e burgosi Stefanin dhe filloi sundimin në mënyrë despotike. Stefan Nemanja, me ndihmën e miqve arriti të arratisë dhe përgatiti hakmarrje ndaj vëllait më të vjetër. Perandori Mihail Komneni, si sovran i Tihomirit, i kishte dërguar atij ndihmë me ushtarë, por në betejën e zhvilluar te Pantina në afërsi të Vuçitërnës dhe Mitrovicës së sotme në Kosovë, forcat e Tihomirit u thyen shumë keq, ndërsa ai vetë e kishte pësuar në ikje e sipër, duke u mbytur në lumin Sitnica. Pas kësaj beteje, Nemanja kishte evituar përzjerjen bizantine, ndërsa vetë iu imponua vëllezërve si zhupan i madh dhe u vu në krye të shtetit të Rashës. (Muhamet Mala)

BETEJA E PEPAJVE (1880). Betejë për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë nga aneksimi malazez. Dështimi i misionit të Ahmet Muhtar Pashës dhe mosndërrhyrja e Fuqive të Mëdha bëri që knjaz Nikollën të ndërmerre sulm kundër forcave të Lidhjes Shqiptare, një mësymje të përgjithshme me 25 batalione me rreth 9,000 veta, e cila u zhvillua javën e parë të muajit janar të vitit 1880, afër Plavës dhe

Gucisë. Synimit malazez forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit iu kundërpërgjigjën me 7,000 vullnetarë nga të gjitha viset shqiptare. Forcat malazeze ishin përqendruar në një sektor të ngushtë (Velikë-Pepaj), ndërsa u sulmuan nga luftëtarët e Nokshiqit të komanduara nga Kurt Asllani dhe Nure Kurti. Pas luftimeve të ashpra forcat malazeze të përbëra nga 4,000 mijë luftëtarë u detyruan të tërhiqeshin. Forcat e Lidhjes, pasi thyen edhe njësitë malazeze të komanduara nga Mark Milani, hynë në territorin malazez, shtinë në dorë Arzhanicën, Velikën e Pepajn dhe u drejtuan për në Murinë. Ushtria malazeze u tërhoq në Sutjeskë. Gjatë betejës së Pepajt dhe të Velikës, të dyja palët patën dëme në njerëz, por, sipas të dhënave të ndryshme, ato të Malit të Zi qenë më të shumta. Shqiptarët lanë në këto luftime edhe dy kapedanët e tyre, Kurt Asllanin e Nure Kurtin. Vrulli patriotik që përshkoi luftën në Velikë e në Pepaj dhe fitorja që korrën shqiptarët kundër ushtrive malazeze më 8 janar 1880 pat jehonë të madhe në opinionin ndërkombëtar, se ata, pavarësisht se ishin nën pushtimin dhe administrimin osman, ishin zot të trojeve të veta. Disfata e detyroi qeverinë malazeze të pezullonte veprimet luftarake në kufi dhe zbatimin e Traktatit të Berlinit t'ia linte në dorë Fuqive të Mëdha. (Fitim Rifati)

BETEJA E RAHOVECIT (19 korrik 1998). Betejë e zhvilluar ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave ushtarake e policore të Serbisë në qytetin e Rahovecit dhe rrethinë. Ishte njëra nga betejat më të ashpra të luftës së UÇK-së kundër forcave serbe. Lufta në Rahovec u zhvillua në rrethana të ndërlikuara, si rezultat i rezistencës së madhe të UÇK-së. Forcat serbe përdorën së paku dy brigada të armatës jugosllave të mekanizuar dhe të përforcuara me njësi speciale dhe paramilitare, si dhe me njësitet e artilerisë së rëndë. Në ofensivën për pushtimin e Rahovecit forcat serbe shfrytëzuan edhe bazat në fshatin Hoçë e Madhe. Gjatë kësaj ofensive u vranë shumë civilë. Masakra më e madhe u bë te Teqja e Rahovecit, në qendër të qytetit, ku nuk kishte asnjë pjesëtar të UÇK-së. Beteja kryesore për Rahovecin u zhvillua më 19 korrik 1998, por vazhdoi edhe në ditët vijuese. Forcat serbe gjatë ditëve të betejës morën peng shumë civilë, disa prej të cilëve u ekzekutuan (midis tyre edhe shehu i Teqes së Rahovecit), ndërsa një numër

syresh u dërguan në vende të panjohura, për fatin e të cilëve nuk dihet asgjë. Strukturat ushtarake dhe civile serbe në Prizren, më 22 korrik 1998 hapën në varrezat e qytetit dy gropa të mëdha për varre masive dhe varrosën aty shumë shqiptarë të vranë gjatë ofensivës në Rahovec. (Valon Brahim)

BETEJA E RZHANICËS (1879). Betejë për mbrojtje të Plavës dhe Guçisë nga aneksimi malazez. U zhvillua në afërsi të fshatit Rzhanicë, ndërmjet forcave vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe forcave ushtarake dhe grupeve të armatosura të Malit të Zi. Zvarritjet e Portës së Lartë për t'ia dorëzuar Malit të Zi Plavën e Guçinë, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, për të tërhequr vëmendjen e Fuqive të Mëdha, e nxitën knjaz Nikollën që të urdhëronte forcat ushtarake malazeze të merrnin me luftë viset e premtuara. Më 31 tetor 1879 forcat malazeze, të cilat vlerësonin se zotëronin pozicione më strategjike dhe më të favorshme luftarake krahas forcave vullnetare shqiptare të drejtuar nga Ali Pashë Guçia, realizuan një sulm të shpejtë ushtarak kundër forcave shqiptare, të cilat kishin organizuar vijën mbrojtëse përballë fshatit Pepaj. Ky sulm, i cili ishte një provokim i hapur malazez, mori përgjigjen e menjëhershme të forcave vullnetare shqiptare. Të nesërmen, më 1 nëntor 1879, forcat malazeze ndërmorën një sulm të njëjtë në afërsi të fshatit Rzhanicë, vranë 30 fshatarë dhe dogjën shumë shtëpi, por pas disa orë luftimesh u zmbrapsën dhe u dëbuan nga forcat vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Disfata e pësuar në Rzhanicë, e cila bëri jehonë edhe në shtypin ndërkombëtar, i dhanë një goditje të fortë dhe e detyruan Malin e Zi të pezullonte përkohësisht inkursionet ndaj viseve shqiptare. (Fitim Rifati)

BETEJA E SHTIMES DHE E SLIVOVËS (1881). Betejë e zhvilluar nga Ushtria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kundër ushtrisë osmane përgjatë rrugës Ferizaj-Prizren. Rreth 4,000 ushtarë të Lidhjes patën përballë rreth 20,000 ushtarë osmanë, të pajisur me armatimin më të mirë të kohës. Forcat osmane, pasi ripushtuan Shkupin (më 23 mars) marshuan drejt Ferizajt. Forcat e Lidhjes, me Mic Sokolin dhe Ali Ibrën në krye, zunë pozicione afër Shtimes, ndërsa pjesa tjetër pranë Slivovës. Luftimet u zhvilluan prej 18-21 prill 1881. Ushtria osmane u hodh

në sulm në front të gjerë dhe e mbështetur nga zjarri i artilerisë. Ushtarët e Lidhjes e thyen më se një herë ushtrinë kundërshtare dhe kundërsulmuan disa herë. Në një nga këto kundërsulme, Mic Sokoli bllokoi me trupin e tij një grykë topi të ushtrisë osmane, të cilën e asgjësoi, por ai ra heroikisht në fushëbetejë, së bashku me luftëtarë të tjerë. Më 21 prill në Slivovë forcat e Lidhjes, për shkak të epërsisë së shumëfishtë të ushtrisë armike, u tërhoqën. Në betejat e Shtimes dhe të Slivovës, të dyja palët patën shumë të vrarë e të plagosur: ushtria osmane rreth 800 veta, ndërsa forcat shqiptare 1,200 veta. (Fitim Rifati)

BETEJA E TABEVE TË LLAPASHTICËS (24-28 dhjetor 1998). Është njëra ndër betejat më të rëndësishme të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Zonën Operative të Llapit, që filluan më 24 dhjetor 1998 dhe vazhduan për pesë ditë me radhë. Operacionet e forcave serbe filluan në vendin e quajtur Tabet e Llapashticës, afër Podujevës dhe u shtrinë në drejtim të Gllamnikut dhe Obrancës. Në Llapashticë të Epërme ishte e vendosur edhe komanda e Zonës Operative të Llapit të UÇK-së. Në këtë betejë UÇK-ja arriti të ruajë pozicionet e saj dhe të konsolidojë edhe më shumë radhët e veta. Në operacionet luftarake të kësaj beteje u vranë 10 pjesëtarë të UÇK-së. Beteja ishte përballja e parë e madhe e UÇK-së, pas marrëveshjes së njohur Hollbruk-Milloshëviq më 13 tetor 1998 dhe pas shpalljes së vetëpërmbytjes së njëanshme nga ana e UÇK-së. Gjatë luftimeve pësuan edhe civilë të këtyre vendbanimeve. (Ismet Cakiqi)

BETEJA E VARNËS (1444). Fitore e ushtrisë osmane mbi ushtrinë e bashkuar të krishterë europiane. Shtetet europiane, të shqetësuara nga zgjerimi i pushtimeve osmane në Ballkan, u bashkuan që të parandalojnë përparimin e mëtejshëm të osmanëve drejt Europës. Në rrethana të këtilla doli në skenë Janosh Huniadi (Hunyadi János, 1407-1456), ushtarak i shquar hungarez me origjinë rumune, i cili korri disa fitore kundër ushtrisë osmane (1442-1443) dhe ngjalli shpresën për dëbimin e këtij pushtuesi nga Ballkani. Ekspedita kundërosmane, që u fuqizua nga Kuvedi i Budapestit (1443), rezultoi me fitoren e ushtrisë së krishterë afër Nishit (nëntor 1443). Fitorja solli marrëveshjen 10-vjeçare midis palëve ndërluftuese në korrik

të vitit 1444. Pjesëmarrjen në luftë, krahas mbretit hungarez, Vladislav Varnečki (1424-1444) dhe Huniadit, e deklaroi edhe Republika e Venedikut. Në këtë ekspeditë luftarake ishte ftuar edhe despoti i Rashës, Gjurgj Brankoviqi, i cili jo vetëm që nuk mori pjesë, por edhe e kishte informuar sulltan Muratin II për ekspeditën e ushtrisë së krishterë, si dhe kishte penguar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun që të kalonte nëpër tokat e tij. Forcat e bashkuara europiane kaluan Danubin në shtator të vitit 1444 dhe marshuan drejt jugut. Atyre u doli përpara sulltan Murati II, pranë Varnës (qytetit bullgar në brigjet e Detit të Zi), i cili më 10 nëntor 1444 iu kundërvu ushtrisë së krishterë me forca disa herë më të mëdha. Në betejë hungarezët dhe forcat e tjera të krishtera kishin epërsi, por fitorja ishte në anën e ushtrisë osmane, sepse Huniadi mori arratinë në kohën kur Vladislavi vazhdoi luftën derisa ra në fushëbetejë. Kjo i la njollë të zezë ushtarakut hungarez. Pas kësaj beteje, osmanët pushtuan Konstandinopojën (1453) dhe ripushtuan despotatin e Rashës (1459), por këtë nuk e arritën me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. (Ramiz Abdyli)

BETEJA E ZHEGOCIT (15 prill 1999) Betejë e zhvilluar ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të Zonës Operative të Karadakut (ZOK) dhe ushtrisë e policisë së Serbisë. Malësia e Zhegocit ishte zonë e lirë dhe aty më 28 mars 1999. Shtabi i Zonës ishte i vendosur në Zhegoc të Poshtëm, kurse efektivit i Brigadës 171 "Kadri Zeka" në Malësinë e Zhegocit. Gjatë muajit prill të vitit 1999 ushtria serbe ndërmori një fushatë në tërë Kosovës, me qëllim të shpartallimit të njësiteve të UÇK-së. Natën e 14 prillit të vitit 1999 forcat serbe rrethuan fshatin Zhegoc nga të katër anët me mijëra trupa dhe me teknikë të rëndë luftarake. UÇK-ja ishte pozicionuar në fshatrat Kishnicë, Brus e Honroc (veri), Llabjan, Parallovë e Bresalc (lindje), Gadish e Ponesh (jug) dhe Sllovi e Akllap (perëndim). Në këtë zonë ishte strehuar edhe popullata civile, rreth 6,000 veta. Në mëngjesin e 15 prillit njësitet pararojë të UÇK-së te Hanet e Zhegocit filluan luftën me forcat serbe, për të penguar hyrjen e tyre në fshat. Që në fillim të betejës forcat e ushtrisë serbe pësuan humbje dhe, në shenjë hakmarrjeje, filluan granatimet mbi pozicionet e UÇK-së dhe popullatën civile. Në mbrojtje të Zhegocit ranë dhjetëra ushtarë

të UÇK-së, u vranë 18 civilë dhe pati shumë të plagosur. Ushtarët e Brigadës 171 “Kadri Zeka” arritën ta mbronin popullatën civile dhe ta çanin rrethimin në drejtim të Marecit. Beteja e Zhegotit pat rëndësi për rrethanat e luftës, sepse territori ishte urë lidhëse në mes të zonave operative të Nerodimes dhe të Llapit. (Ali Uka)

BETEJAT E MAZHIQIT (10 korrik 1998-15 shtator 1998). Përballa e parë e drejtpërdrejtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me ushtrinë serbe dhe lufta më e gjatë e UÇK-së në vitin 1998. Beteja filloi më 10 korrik, me takimin e papritur të vëzhguesve të ushtrisë serbe me disa ushtarë të UÇK-së të Zonës Operative të Shalës. Me këtë rast u plagosën disa nga vëzhguesit serbë. Të nesërmen, më 11 korrik, forcat serbe morën përfundim. Nga ajo ditë luftimet vazhduan pa ndërprerje, deri më 15 shtator 1998. Njësitin e komandonte Ajet Bajrami, por ishin të angazhuara edhe njësitet e tjera të Brigadës “Mehë Uka”. Luftimet dhe granatimet u përqendruan nga Kutlloci-Shkoza e Madhe (Mazhiq) deri në Trepçali, ndërsa granatimet nga minahedhës dhe topa deri në 155 mm arrinin deri kah mesi i Bajgorës. Gjatë luftimeve u shpërngulën pothuajse të gjithë banorët e fshatrave Mazhiq, Trepçali, Tërstenë, Kutllac, Stantërg dhe një pjesë e fshatit Bare. Lufta më e ashpër dhe me humbje më të mëdha u zhvillua më 15 shtator. Serbia kishte angazhuar ushtri, polici, paramilitarë dhe mercenarë në këtë betejë, si dhe një arsenal prej 375 mjedesh të blinduara dhe logjistike. Pati shumë të rënë nga radhët e UÇK-së, ndërsa forcat serbe më pas dogjën dhe fshatërruan 789 shtëpi, të gjitha shkollat e fshatrave, vranë bagëti, dogjën ushqimin e kafshëve dhe të gjitha rezervat ushqimore. (Emin Musa)

BETIMET. Shprehje të shkurtra folklorike në formë formulash, të cilat thuhën për t’u mbrojtur nga akuzat e pavërteta ose për t’i bindur të tjerët për ndonjë çështje. Thuhën edhe për të pohuar ose mohuar një premtim të dhënë. Në disa lloje të tjera krijimesh folklorike ruhen disa betime të kohëve të lashta pagane: betimi në tokë, në diell, në hënë, në bukë etj. Betimet më të vona u ngarkuan me elemente fetare: betimi në ungjill, në kuran etj. Betimet bartin gjurmë të një besimi të lashtë të traditës shqiptare, ku shprehet bindja e thellë në forcën magjike të fjalës dhe të objektit që përmendet

gjatë betimit të shenjtë simbolik. Betimet përmbajnë shprehje emocionale, me qëllim që të përforcojnë fjalën e thënë. Duke u bazuar në kultin e besës shqiptare, ato patën funksion të veçantë në të drejtën zakonore si vlerë e provës, por edhe karakter ceremonial, kur i akuzuari shfaqësonte veten. Ndër betimet e shpeshta të shënuara në vise të ndryshme të Kosovës janë: “Pasha atë diell!”, “Pasha atë diell e hanë!”, “Pasha këtë gur!”, “Pasha këtë bukë!”, “Pasha besën!”, “Pasha kryt e nonës!”, “Pasha kryt e babës!” etj. Sot, me krijimin e marrëdhënieve të reja shoqërore, betimet e lashta pothuajse janë zhdukur. (Leontina Musa)

BETIMI I USHTRISË ÇLIRIMTARE (1998).

Akt solemn i pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), me rastin e përfshirjes në formacionet ushtarake. Teksti i betimit për pjesëtarët e UÇK-së u shkrua që nga themelimi i njësisë të para. Qëllimi i betimit ishte krijimi i një atmosfere mobilizuese në radhët e luftëtarëve, besnikëria ndaj detyrave ushtarake, zbatimi i urdhrave komanduese dhe veprimi në përputhje me ligjet e luftës. Të gjithë ushtarët rreshtoheshin para Flamurit Kombëtar dhe eprorëve të UÇK-së, secili duke lexuar tekstin e betimit: “Unë, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë pa kursyer as jetën time të luftoj për t’i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut. Nëse e shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem, betohem, betohem!” Përveç mijëra luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me këtë betim luftuan edhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc dhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. (Ali Uka)

BEVINGTON Geri Lojd (Bevington Gary Loyd) (1944-). Gjuhëtar amerikan, profesor. Lindi në Fort Madison, Iowa. Kreu studimet universitare në Middlebury College, ku më pas mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1970) me një temë mbi sistemin fonologjik të shqipes në Massachusetts, ku filloi karrierën akademike (1970-71), për të vijuar në Universitetin e Çikagos (1971). Ndër botimet e tij

veçohet “Fonologjia e shqipes” (Albanian Phonology, 1974). Ky është studimi i parë monografik gjenerativist mbi sistemin fonologjik të shqipes. Bevington është anëtar i Këshillit të Lektorëve për Shkëmbime Ndërkombëtare (1991), anëtar i asociuar i Shoqatës Gjuhësore të Amerikës (Linguistic Society of America) etj. U mor me akcentologjinë e shqipes. (Aljula Jubani)

BEXHETI Nuri (1967-). Historian, profesor universiteti. Lindi në fshatin Dobrosht të Tetovës, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për histori i kreu në Universitetin e Prishtinës. Kreu studimet e magistraturës në Universitetin e Vjenës, ndërsa studimet e doktoratës në Institutin për Europën Juglindore në Vjenë, ku mbrojti edhe temën e doktoratës “Pjesëmarrja e shqiptarëve në luftën e madhe turko-austriake 1683-1699”. Që nga viti 2006 është mësimdhënës në departamentin e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëron lëndët nga historia, diplomacia dhe historia e Europës Juglindore. Ka drejtuar revistën shkencore “Universitas”. Kreu edhe detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë. Vepra e tij shkencore përmbëhet nga studime monografike, trajtesa të veçanta dhe një numër artikujsh shkencorë për çështje të ndryshme historike. Disertacioni i tij u botua në vitin 2009 në versionin gjermanisht. (Selim Bezera)

BEZISTANET. Çarshi të mbyllura të stilit oriental, me shumë dyqane, kryesisht të tekstilit. Për shkaqe sigurie ishin të ngritura me material të fortë ndërtimor, të mbuluara me kupola ose çati. Në bezistane shiteshin edhe stoli. Në Kosovë ishin më të pakta bezistanet. I njohur ishte bezistani i Prizrenit. Në bërthamën e qytetit, në pjesën veriore të Lumbarshit, gjatë periudhës osmane ishte ndërtuar Arasta Çarshia (Bezistani). Në fillim të shekullit XIX dyqanet e këtij kompleksi fillonin nga Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe vazhdonin në jug, pranë dhe përballë Xhamisë së Arastës, duke vazhduar mbi urën qendrore të Lumbarshit. Ura ishte e gurit dhe mbi të ishin ndërtuar dyqanet që lidheshin me bregun jugor, me çarshinë kryesore dhe shatërvanin. Në perëndim dyqanet e Arasta Çarshisë vazhdonin deri në afërsi të Urës së Gurit. Një pjesë e Arastës u dogji në vitin 1853, por u rindërtua. Në vitin

1913 dyqanet e Arastës u plaçkitën dhe dogjën nga Serbia. Gjatë viteve 1956-1960, edhe ato pak dyqane dhe shtëpi orientale të mbetura, pushteti komunist jugosllav i rrënoi dhe aty ndërtoi banesa shumëkatëshe. Rrënimit i shpëtoi vetëm minarja e Xhamisë së Arastës.

I njohur ishte edhe bezistani i Prishtinës, i cili i takonte zonës kryesore të çarshisë dhe gjendej përballë Xhamisë së Çarshisë. Ky bezistan, apo çarshi e mbuluar, pësoi dëme të konsiderueshme gjatë Luftës së Parë Botërore, por rrënimin përfundimtar e pësoi nga pushtetarët komunistë, të cilët në vitet '60 të shekullit të kaluar e rrënuan në tërësi dhe në vend të tij ndërtuan sheshin “Vëllaznim-Bashkim”. (Parim Kosova)

BËRDYNAJ Mulla Zekë (1918-1987). Titullar i fesë islame. Lindi në fshatin Novoselë të Pejës. Pas mejtepit në fshatin e lindjes, kreu medresenë në Pejë dhe Gjakovë. Në vitin 1938 hapi mejtepin e tij në fshatin Radavc, ku përveç lëndëve të besimit dhe të gjuhës amtare, u mësonte nxënësve edhe dije të përgjithshme. Gjatë viteve 1941-1944 ishte pjesëmarrës në luftërat e Rozhajës dhe të Novi-Pazarit kundër çetave çetnike. Në njërin prej këtyre betejave, në vitin 1943, si komandant i çetave vullnetare, u plagos rëndë në masakrën e Bihorit. Në vitin 1948 u burgos dhe i kaloi shumë vjet nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë, në Nish 4 vjet dhe në Goli Otok 8 vjet (1952-1960), i dënuar si “armik i popullit”. Pas vuajtjes së dënimit u kthye në vendlindje dhe ushtroi detyrën e imamit dhe të mualimit në xhaminë e fshatit Novoselë të Pejës. Duke qenë me autoritet dha kontribut të çmuar në pajtimin e gjaqeve. (Resul Rexhepi)

BËRTHAMAT E PËRBASHKËTA PROGRAMORE. Përmbajtje mësimore nga lëndët të ndryshme të përbashkëta dhe të detyrueshme për të gjithë nxënësit e shkollave të tipit e të nivelit të njëjtë. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës më 1989, Kuvendi i Serbisë miratoi disa ligje me synim unitarizimin e sistemit të arsimit në Serbi, duke përfshirë edhe Kosovën. U hartuan edhe “Bërthamat e përbashkëta programore”, të cilat përmbanin përmbajtje programore unike për shkollat fillore dhe të mesme në territorin e Serbisë, duke përfshirë edhe shkollat dhe arsimin në Kosovë. Planet dhe programet mësimore të shkollave shqipe

në Kosovë pësuan ndryshime qenësore, në dëm të kulturës dhe edukimit kombëtar shqiptar. Në mënyrë të veçantë u varfëruan përmbajtjet nga gjuha dhe letërsia shqipe, historia, muzika dhe fushat e tjera të kulturës dhe trashëgimisë kombëtare shqiptare. U bë edhe përzgjedhja e shkrimtarëve shqiptarë dhe veprave të tyre, nga këndvështrimi serb. Për realizimin e këtyre synimeve, Serbia ndërmoi edhe hapa konkretë, siç ishte edhe formimi i “paraleleve të përziera” në Kosovë, ku mësimi do të zhvillohej në gjuhën serbe dhe shqipe. Kundër këtyre përpjekjeve për unitarizimin dhe serbizimin e arsimit në Kosovë reagues me forcë organet qeverisëse të Kosovës dhe populli i saj. “Bërthamat e përbashkëta programore” në arsimin kosovar mbeten një përpjekje e dështuar e Serbisë për të serbizuar arsimin në Kosovë. (Islam Krasniqi)

BËRXULLI Dashmir (1976-). Psikolog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Durrës. Arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, kurse studimet për psikologji i kreu në Universitetin Jugperëndimor në Bllagoevgrad, Bullgari. Në vitin 2003 u zgjodh ligjërues në departamentin e psikologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. U doktorua më 2009 në Universitetin “Ludwig Maximilians” në Muni të Gjermanisë. Është bashkautor i librave “Psikologjia 11” dhe “Psikologjia 12” për shkollat të mesme në Kosovë dhe autor dhe bashkautor i disa artikujve nga fusha e historisë së psikologjisë, psikologjisë sociale, psikologjisë së personalitetit, të drejtave të njeriut dhe edukimit etj. Ka marrë pjesë në komisionet të veçanta profesionale të institucioneve publike në Kosovë, si dhe në projekte të tjera vendore dhe ndërkombëtare. Ushtri detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. (Kaltrina Kelmendi)

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS (Arkitektura). Pallati i librit, godinë monumentale dhe e rëndësishme e dijes, një ndër ekzemplarët e arkitekturës moderne të ndërtuara në vitet ‘70 dhe ‘80 në Kosovë. Projektues i objektit është ark. Andrija Mutnjaković nga Zagrebi, ndërsa dokumentacionin projektues e përgatitën “Centroprojekti” nga Zagrebi dhe Beogradi. Ndërtues kryesor ishte Kombinati ndërtimor “Ramiz Sadiku” nga Prishtina, ndërsa në ndërtimin e objektit morën pjesë mbi 50



BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS

ndërmarrje nga mbarë ish-Jugosllavia dhe dy firma jashtë vendit. Enterierin e Bibliotekës e realizoi ndërmarrja “Tefik Çanga” nga Ferizaj. Ndërtimi filloi në vitin 1975, ndërsa përfundoi në vitin 1981. Përirimi solemn i ndërtesës u bë më 25 nëntor 1982. Godina ka 16,500 m², nga të cilat 13,500 janë sipërfaqe shfrytëzuese. Organizimi funksional i Bibliotekës është bërë në bazë të përvojave të bibliotekave bashkëkohore të njohura në botë, me organizimin e hapësirave të leximoreve dhe depove për vendosjen cilësore të fondit të librave. Kapaciteti i përgjithshëm në sallat e leximit është 600 vende. Ka dy salla të leximit me 400 vende, sallën e periodikut, sallat për fonde të posaçme dhe hapësirat për hulumtues shkencorë, amfiteatrin e madh me 150 ulëse dhe 40 ulëse në galeri dhe amfiteatrin e vogël me 75 ulëse. Biblioteka në të gjitha depot ka hapësirë për vendosjen e 2,000,000 librave. Koncepti arkitekturor i ndikuar nga elementet e arkitekturës vernakulare: nëntëdhjetë e nëntë kupola me madhësi të ndryshme, të shtrira mbi hapësira të strukturuar në formë të kubeve. Ndërtesa është e modeluar nga betoni, skulpturë monolite dhe e fuqishme. Paraqet kërkim të ndërlidhjes konstruktive-metabolike, stil arkitektonik brutalist me përdorimin e betonit natyror, me futjen e plastikës arkitektonike, ornamenteve të çelikut në fasadë, elemente dekorative të frymëzuara nga artizanati i filigranit në Kosovë. (Vlora Navakazi)

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS “PJETËR BOGDANI” (BKK). Është institucioni më i lartë bibliotekar në Kosovë, që merret me depozitimin dhe ruajtjen e librit si pasuri dhe memorie kombëtare. Zhvillimi i BKK-së ka kaluar nëpër faza të ndryshme, varësisht nga rrethanat politike dhe avancimi

kulturor dhe institucional i Kosovës. U themelua në Prizren nga fundi i vitit 1944 si Bibliotekë Regjonale e Krahinës së Kosovës e Metohisë, emër të cilin e mbajti deri në vitin 1952. Dy vjet pas themelimit ajo u bart në Prishtinë, bashkë me institucionet e tjera qendrore të Kosovës. Më 1953 Biblioteka u mbyll dhe tërë fondi i saj bibliotekar iu dha në dispozicion bibliotekës së qytetit të Prishtinës "Milladin Popoviq". Kjo periudhë e zhbërjes së Bibliotekës zgjati 10 vjet, deri në vitin 1962, kur u hap përsëri dhe u vendos në objektin e tanishëm të Galerisë së Arteve të Kosovës. Vazhdimësinë e punës së një institucioni qendror të bibliotekarisë në Kosovë gjatë kësaj periudhe e mbajti Qendra Bibliotekare e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (1956-1961). Në periudhën 1961-1970 ajo mbajti emrin Biblioteka Popullore Krahinore, kurse në periudhën 1970-1990 u quajt Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, periudhë kur statusi institucional i Bibliotekës avancoi bashkë me statusin politik të Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë. Pas suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës nga Serbia, më 1990 Biblioteka mori emrin Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës dhe Metohisë. Ndërkaq, nga qershori i vitit 1999 u quajt Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, ndërsa më 2014 emërohet Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani". Nga shtatori i vitit 1981 BKK e zhvillon veprimtarinë e saj në objektin ku ndodhet edhe tani.

Nga viti 1990 deri në vitin 1999 Serbia aplikoi masat e dhunshme në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Gjatë këtyre viteve lexuesve shqiptarë iu mohua e drejta për të frekuentuar Bibliotekën dhe për të shfrytëzuar fondin e saj. Në këtë periudhë në fondin e Bibliotekës u shtuan rreth 22,000 libra, të gjitha në gjuhën serbe dhe asnjë në gjuhën shqipe, ndërsa u zhdukën rreth 100,000 libra në gjuhën shqipe, të destinuara për shkëmbim dhe për pasurimin e bibliotekave lokale të Kosovës. Gjatë ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, në periudhën mars-maj 1999, Biblioteka ishte edhe bazë e ushtrisë serbe.

Sipas ligjit në fuqi (2012) BKK është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar. Aktiviteti i dhe funksioni i saj është i ngjashëm me bibliotekat e tjera kombëtare në shtete të ndryshme të botës: BKK është qendër e mble-

dhjes dhe e depozitimit kopjes së detyrueshme të librave të botuar në Kosovë; pasuron koleksionin e saj arkivor me botime të formateve dhe llojeve të ndryshme, me qëllim të ruajtjes së përhershme të tyre; është qendër e krijimit dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmbledhës (e bazës së të dhënave për librin); është qendër e përgatitjes dhe ofrimit të informacionit bibliografik; është qendër metodike për zbatimin e standardeve dhe të rekomandimeve ndërkombëtare në veprimtarinë bibliotekare; është qendër për restaurimin, konservimin, riprodhimin, mikrofilmimin dhe digjitalizimin e materialeve bibliotekare; është qendër për koordinimin e rrjetit bibliotekar të Kosovës etj. Gjithashtu BKK bën katalogimin e librit në botim CIP dhe pajisjen e botimeve me numrat standard ndërkombëtarë ISBN, ISMN dhe ISSN të botuesve në Kosovë.

Sipas të dhënave nga revizioni i koleksioneve bibliotekare të vitit 2004, BKK disponon me 1,890,194 njësi bibliotekare, me 475,324 tituj, nga të cilat: 382,806 libra, 281,591 revista, 984,022 gazeta dhe 241,775 botime të tjera. Në periudhën vijuese, përmes ekzemplarit të detyrueshëm, blerjes dhe dhuratave fondi i BKK-së është rritur edhe me mbi 30,000 tituj të rinj. (Izet Abdyl)li)

BIBLIOTEKAT E PERIUdhËS OSMANE.

Gjatë periudhës osmane në Kosovë janë formuar disa lloje bibliotekash (kytyphane), si bibliotekat private, të xhamive, të teqeve, të mejtepeve, të medreseve dhe bibliotekat publike.

Biblioteka private në këtë periudhë kanë themeluar personalitete të ndryshme nga shtesa drejtuese dhe inteligjencia vendëse, si: pashallarë, bejlerë, myftilerë, kadilerë, myderrizë, imamë, shehlerë, mualimë etj. Janë ruajtur dëshmi për biblioteka private të Koxha Sinan Pashës, Mehmed Kukli beut, Murad Beut, Hasan Xihës, Mahmud Pashë Rrotllës, Emin Pashë Rrotllës, Jashar Pashë Gjinollit, Maliq Pashë Gjinollit, Junus Efendiut, ish-myftiu i Prishtinës Hysejn haxhi Sadikut, Hasan efendi Nahit etj. Njëra nga bibliotekat e xhamive për të cilën janë ruajtur dëshmi është biblioteka e xhamisë së Çarshisë në Prishtinë, e themeluar në vitin 1561.

Nga bibliotekat e teqeve, për të cilat janë ruajtur dëshmi materiale ose të shkruara janë: Biblioteka e Teqesë Qendrore Halveti në

Prizren, e themeluar pas ngritjes së Teqesë nga sheh Osman Baba në vitin 1713. Kjo bibliotekë aktualisht ruan edhe 49 dorëshkrime, disa nga të cilat janë të kohës së themelimit të saj; biblioteka e Teqesë së Madhe Halveti në Rahovec, e themeluar pas ngritjes së Teqesë nga sheh Sylejman Baba në vitin 1732 (koleksioni i dorëshkrimeve të ruajtura të kësaj biblioteke ka 196 njësi); Biblioteka e Teqesë së Madhe në Gjakovë, e themeluar nga shehu i parë i saj Sylejman "Akhiz" Baba në vitin 1714; biblioteka e Teqesë Kaderi në Prizren, e ngritur nga Hasan Baba në vitin 1646; biblioteka e Teqesë bektashiane në Tetovë, e njohur si Teqeja e Harabati Babës, e themeluar në gjysmën e dytë të shek. XVIII nga Harabati Baba; biblioteka halvetiane e Teqesë së sheh Musa Efendiut, e ngritur në Prizren në vitin 1575 etj.

Ndërkaq, bibliotekat më të vjetra të mejtepeve janë: biblioteka e mejtepit të Suzi Prizrenit, e ngritur para vitit 1513; biblioteka e mejtepit të Mehmet Kukli-Beut në Bresanë (ish-Zinovë) të Opojës, e ngritur para vitit 1538; biblioteka e mejtepit të Koxha Sinan Pashës, e ngritur në Kaçanik para vitit 1586; biblioteka e mejtepit të Halil Efendiut, e ngritur para vitit 1774 në Gjakovë etj.

Çdo medrese e periudhës osmane ka pasur bibliotekën e vet. Në to janë koleksionuar vepra nga disiplina të ndryshme shkencore, artistike dhe fetare. Biblioteka më e vjetër e këtij lloji është ajo e Medresesë së Is'hak Beut në Shkup, e ngritur rreth vitit 1411. Koleksioni fillestar i bibliotekës kishte 24 vëllime dorëshkrimesh. I biri i Is'hak Beut, Isa Beu, para vitit 1469 themeloi bibliotekën deri atëherë më të pasur në këto vise, pranë medresesë së tij në Shkup, e cila kishte mbi 330 vëllime dorëshkrimesh. Në shek. XVI u ngritën biblioteka të medreseve në të gjitha qytetet shqiptare të asaj kohe. Në Prizren Medreseja e Mehmet Pashës (1537) ka pasur bibliotekën nga më të pasurat në trojet shqiptare. Edhe sot janë ruajtur mbi 400 vëllime dorëshkrimesh të kësaj biblioteke. Biblioteka ka pasur edhe Medreseja e Vushtrrisë (shek. XV), Medreseja e Vjetër e Pejës (1516), Medreseja e Madhe e Gjakovës (1707), Medreseja e Besharet Beut në Prishtinë (para vitit 1566) etj.

Biblioteka e parë, që është themeluar si institucion në vete, është biblioteka e ngritur në vitin 1601 në Shkup, nga Mehmet Pashë Kaçaniku. Ai i dhuroi kësaj biblioteke koleksionin e parë që kishte 50 vëllime dorëshkrimesh, bibliotekarit

i caktoi pagën dy akçe në ditë dhe e ngarkoi me detyrimin e kompensimit të çdo libri të humbur. Bibliotekën e parë publike në Prizren e ka ndërtuar Said Pashë Rrotlla, në vitin 1805. Kjo ndërtesë tani funksionon si Biblioteka e Kompleksit Përkujtimor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Bibliotekën e parë publike në Pejë, të njohur si Biblioteka e Bolla-zades, e ka ngritur Numan Pasha i Mahmudbegollëve në vitin 1805. Bibliotekat e kësaj periudhe, sikurse edhe institucionet e tjera edukative arsimore dhe fetare, janë ngritur ekskluzivisht sipas sistemit të vakëfit kryesisht nga donatorët dhe legatorët vendës. (Nehat Krasniqi)

BIBLIOTEKAT SHKOLLORE. Biblioteka të shkollave fillore dhe të mesme, të cilat nxënëseve, stafit mësimor dhe prindërve u krijojnë mundësi për shfrytëzimin e librave, revistave, gazetave etj., kryesisht për qëllime mësimore. Bibliotekat shkollore në Kosovë i kanë fillat të shkollat e para. Në vitin 1954 kishte 103 biblioteka të tilla. Numri i tyre u rrit vazhdimisht, kështu që sot pothuaj çdo shkollë e ka bibliotekën e vet. Disa nga këto biblioteka kanë edhe salla leximi. (Ismet Potera)

BICAJ Isa (1946-). Historian, mësimdhënës. Lindi në Vrellë të komunës së Istogut. Studimet universitare i përfundoi në degën e historisë të Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1972), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin e Tiranës (1998). Punoi mësimdhënës në shkollën fillore "Hysni Zajmi" në Vrellë të Istogut, pastaj në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë. Nga viti 1994 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë, më pas ligjërues në Universitetin e Tetovës dhe në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, qendra në Gjilan. Është autor i disa teksteve shkollore dhe fletore pune të historisë për shkolla fillore dhe të mesme. Mori pjesë në një sërë aktiviteteve shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ishte anëtar i këshillit për hartimin e programeve mësimore të historisë për shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës. Botoi një numër studimesh në revista shkencore dhe është autor i monografisë "Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze 1881-1914" (2003). (Frashër Demaj)

BICAJ Ismet (1958-1999). Pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero

i Kosovës. Lindi në fshatin Vrellë të komunës së Istogut. Në vitet 1982-1998 jetoi në emigrim, në Austri, Belgjikë, Gjermani dhe Suedi. Ishte pjesëmarrës në aktivitetet që mbaheshin për çështjen e Kosovës. Në qershor të vitit 1998 iu bashkua radhëve të UÇK-së, në fshatin e lindjes, ku së bashku me veprimtarë të tjerë u angazhua për organizimin e njësiteve të UÇK-së dhe përgatitjen për hapjen e frontit të luftimeve edhe në fshatrat e komunës së Istogut. U emërua zëvendëskomandant i batalionit II i Brigadës 133 "Adrian Krasniqi", si dhe ndihmëskomandant i kësaj brigade për ndërlidhje. Më 12 prill të vitit 1999 u plagos rëndë në përballje me forcat serbe rrëzë fshatrave Vrellë e Lubozhdë, dhe më pas vdiq. Në shkurt të vitit 2016 u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Sabit Sylaj)

BICAJ Muhamet (1943-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Vrellë të Istogut. Shkollimin bazë e kreu në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet për kimi i kreu në Fakultetin



MUHAMET BICAJ

Filozofik të Universitetit të Prishtinës në vitin 1967. Punoi mësimdhënës i kimisë në gjimnazin e Prishtinës, më pastaj punoi në industrinë e gomës "Ballkan" të Suharekës dhe në Odën Ekonomike të Kosovës. Studimet pasuniversitare

dhe tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Zagrebit (1984). Në vitin 1972 zgjidhet asistent për lëndën e kimisë organike në FSHMN të Universitetit të Prishtinës dhe në vitet vijuese gradohet me të gjithë titujt universitarë. Ka publikuar punime në disa revista shkencore. Ka ushtruar detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shtetërore të Kosovës, si sekretar Krahinor i Arsimit, i Shkencës dhe i Kulturës dhe më vonë ministër i Arsimit në Qeverinë e Kosovës në emigrim. (Nexhat Daci)


BICAJ Riza (1930-2015). Mësimdhënës, gazetar. Lindi në fshatin Vrellë të Istogut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Normalen në Prishtinë. Diplomoi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik në Beograd. Disa vjet punoi mësimdhënës i gjuhës dhe

letërsisë shqipe në gjimnazin e Gjilanit dhe të Prishtinës, pastaj në gazetën e përditshme "Rilindja", si gazetar dhe redaktor, deri në pensionim. Për shumë vjet ishte hartues dhe redaktor i rubrikës "Enciklopedia e vogël", ku trajtoheshin edhe tema për ngjarje dhe personalitete kombëtare. Në vitin 2000 botoi librin "Enciklopedia e vogël, 777 pyetje - 777 përgjigje". Ishte përpilues edhe i disa teksteve shkollore për gjuhën. Vdiq në SHBA. (Nehat Islami)

BIÇAKU V. Eshref (1936-2006). Mjek, radiolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, kurse studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1962). Pas diplomimit u punësua në Shtëpinë e Shëndetit në Malishevë. Pas specializimit në radiologji u kthye në qytetin e lindjes, në Qendrën Mjekësore të Prizrenit. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë u vendos në Prishtinë dhe më pas në këtë fakultet mbrojti edhe disertacionin e doktoratës (1978). Së pari ishte ligjërues dhe më pas, pas specializimit në Pragë dhe mbrojtjes së doktoratës, mori titullin profesor inordinar i lëndës së radiologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Botoi një numër punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor dhe është autor i teksteve universitare "Rëntgenologjia stomatologjike" (1998), "Fjalor terminologjik i radiologjisë" (2006). (Xhavit Bicaj)

BIÇOKU Kasem (1940-). Historian medievalist. Lindi në Elbasan, ku kreu shkollimin fillor e të mesme. Kreu studimet për histori në Universitetin e Tiranës (1962), ndërsa studimet e doktoratës nga lëmi i mediavalistikës i mbaroi në vitin 1995. Në vitet 1993-1997 ishte drejtor i Institutit të Historisë së Shqipërisë, kryeredaktor i revistës "Studime historike" dhe drejtor i Muzeut Historik Kombëtar (2008-2010). Botoi një sërë monografish dhe punime shkencore nga fusha e mediavalistikës të periudhës së Skënderbeut: "Skënderbeu 1468-1968" (bashkautor, 1968); "Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Bibliografi, 1454-1835", (bashkautor, 1997), "Skënderbeu dhe Shqipëria e kohës së tij" (2005), "Për Skënderbeun" (2005). Është gjithashtu autor i një sërë studimesh nga historia mesjetare, ku gjenden edhe njoftime të reja për arealin e sotëm të Kosovës gjatë periudhës së Skënderbeut. (Jahja Drançolli)

BIDER Françesko (1961-1999). Luftëtar italian i UÇK-së, dëshmor. Lindi në Alpet Desate (Daser) në Rossaza të Italisë. Ndoqi studimet për gjuhë dhe mjekësi. Një kohë punoi në Indi



FRANÇESKO BIDER

dhe pastaj në Biella, në një ndërmarrje tekstili. Si humanitar qëndroi disa herë në Bosnjë, në Sarajevë, Tuzëll, Gorazhdë, Mostar etj. Në prag të luftës, me mision humanitar qëndroi edhe në Kosovë, por u dëbua nga policia e Serbisë. Më pas shkoi në Kukës (Shqipëri), ku iu bashkua organizatave humanitare italiane. Këtu mori vendim që, së bashku me disa luftëtarë nga Gjermania, Franca, Algjeria, Anglia, SHBA-ja të përfshihet në luftën për çlirimin e Kosovës. U fut në Koshare dhe u sistemua në Brigadën 138 "Agim Ramadani". Bënte pjesë në formacionin ushtarak të batalionit të dytë, në repartin e Padeshit. F. Bider, së bashku me disa të huaj të tjerë, më 7 maj 1999 ndodhej në pikën e vëzhgimit në Padesh, ndërsa zhvilloheshin luftime të rrepta në mes palëve ndërluftuese. Pozicioni ku ndodhej ai u godit me armë të rënda artilerie, me ç'rast F. Bider bie dëshmor. U varros me nderime të larta ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Bajram Curr të Shqipërisë, ndërsa pas luftës u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve në Koshare. Më 2006 u botua një përmbledhje me rrëfime dhe poezi të F. Biderit, e titulluar "La Mimosa". (Ruzhdi Jashari)

BIENALJA NDËRKOMBËTARE E VIZATIMIT. Manifestim tradicional pamor i Shoqatës së Artistëve Figurativë dhe Aplikativë të Kosovës, i themeluar në vitin 1975 nga piktorët Engjëll Berisha, Muslim Mulliqi, Tahir Emra etj. Përmes këtij manifestimi, që organizohet një herë në dy vjet, synohet të zhvillohet dhe të çohet përpara disiplina e vizatimit, të cilin sot ka filluar ta zbehtë kompjuteri dhe risitë e tjera teknike. Bialja e Vizatimit pas luftës së vitit 1999 pati një ndërprerje të imponuar njëvjeçare, por e mori veten sërish dhe vazhdoi funksionimin me ekspozimin e veprave të krijuesve pamorë vendorë, por edhe të atyre ndërkombëtarë. Që nga themelimi e deri në ekspozitën e fundit të Bienales, qasjet, përjetimet, materializimet kanë qenë të shumënduarshme, prej atyre

realiste deri te konceptualistet. Nga ky koncept dallon Bialja XI e organizuar në mars të viti 2000, menjëherë pas luftës në Kosovë, ku kryesisht dominuan pamjet dhe skenat e rënda të vuajtjes njerëzore, si: ikja, ankthi, qëndresa, mbijetesa, tematika që ishin të pranishme te pjesëmarrësit e kësaj bialjeje, i ndryshëm nga ata të më hershmit. (Hivzi Muharremi)

BIFURKACIONI I NERODIMES. Dukuri e rrallë hidrografike, kur një lumë ndahet në dy degë që pastaj rrjedhin në drejtim të dy deteve të ndryshme. Nododhet në pjesën jugore të Fushës



PAMJE E BIFURKACIONIT TË NERODIMES

së Kosovës. Vendi i bigëzimit (bifurkacionit) të lumit ndodhet 1.5 km në perëndim të Ferizajt, në lartësi mbidetare 588 m. Lumi Nerodime gjatë rrjedhjes së tij nga malet e Jezercit dhe të Nerodimes, në afërsi të fshatit Nerodime e Poshtme ndahet pakthyeshem në dy degë, ku njëra (e djathta) rrjedh në drejtim të Lepencit, që pastaj vazhdon në Vardar dhe në detin Egje, kurse tjetra (e majta) rrjedh në drejtim të Përroit të Sazlisë, që derdhet në lumin Sitnica dhe pastaj shkon në pellgun e Detit të Zi. Në aspektin morfologjik, Bifurkacioni i Nerodimes është krijuar në ujëndarësin e ulët dhe të ndërtuar nga sedimentet e buta (liqenore e lumore). Vendi i bifurkacionit është njëherësh ujëndarësi detar në mes të Detit të Zi dhe Egje. Nga kjo pjesë, Fusha e Kosovës merr pjerrësi në dy drejtime, të veriut (Sitnicës) dhe të jugut (Lepencit). Bifurkacioni i Nerodimes është vënë nën mbrojtje ligjore

(1979), si rezervat i veçantë i natyrës për vlerat morfohidrologjike. Sipërfaqja e mbrojtur është rreth 12 hektarë. (Ruzhdi Pllana)

BIGAMIA/POLIGAMIA. Forma të martesës me dy, përkatësisht me më shumë partnere. Dasma (*gamos*), si ritual, imponohet si akt që në kontekstin e rrethanave sociopolitike të kohës, në shoqëri të paorganizuar politikisht, kanë vulosur aktin e miratuar nga dëshmitarët dasmorë. Miqësia ndërmjet familjeve dhe martesë e çiftit është bërë publike para krushqve. Këto forma të martesës i kanë edhe dy variantet e veta: a) poligjininë (një burrë me më shumë gra), dhe b) poliandrinë (një grua me më shumë burra). Derisa për variantin e poliandrisë nuk ka të dhëna se ndonjëherë është lidhur si dukuri me ambientet shqiptare (përveç ndonjë rasti shumë të rrallë), poligjinia me variantin e saj të bigamisë, si formë historike e martesës me dy gra, në Kosovë ka mbijetuar. Ligjet pozitive as në Kosovë dhe as në disa ambiente të tjera jashtë saj nuk e zyrtarizojnë bigaminë, mirëpo ajo funksionon dhe praktikohet me miratimin e ligjeve fetare islame, për ndryshim nga poligamia që është fenomen shumë i rrallë ndër shqiptarët. Historia dëshmon se këtij zakon të lashtë nuk i kanë rezistuar as shqiptarët e konfesionit katolik. Në Mirditë, ku kanë jetuar vetëm shqiptarët katolikë, nëse gruaja e parë nuk kishte fëmijë, është marrë gruaja e dytë dhe pikërisht me motivin kryesor të lindjes së fëmijëve. Mirëpo, për ndryshim nga ligjet e fesë islame që janë shumë tolerante ndaj kësaj dukurie, ligjet kishare përgjithësisht, e sidomos ato katolike, janë shumë strikte në respektimin e monogamisë, gjë që pothuajse ka rezultuar me çrrënjosjen e saj te besimtarët e krishterë. Në Kosovë vazhdon një trend i jetës martesore me “ortake”, për shkak të fëmijëve ose edhe për sigurimin e pasardhësit djalë. Megjithatë, mund të thuhet se kjo dukuri është në zhdukje e sipër. (Anton K. Berishaj)

BIKLIQI Muhamet (1990-). Balerin. Lindi në Janjevë të komunës së Lipjanit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje. Mësimet për balet i mori në shkollën e mesme të muzikës “Prenkë Jakova” në Prishtinë. Që nga viti 2010 është i angazhuar në trupën e baletit të Kosovës në kuadër të Tetarit Kombëtar të Kosovës në Prishtinë. Ka luajtur në 23 shfaqje të baletit dhe në disa shfaqje të tjera teatrore. (Ragip Sylaj)

BILAÇI. Vendbanim rural i tipit të dendur, 18 kilometra larg Bujanocit. Shtrihet në të dy anët e përroit të Bilaçit (degë e djathtë e Moravicës së Preshevës), në kontaktin e fushës së Preshevës me shpatet perëndimore të Rujanit, në lartësi mbidetare 460-500 m. Fshati shtrihet në një sipërfaqe prej 1,780 ha. Të dhënat e para për Bilaçin datojnë qysh nga shekulli XV, ndërsa në defterët e vitit 1519 fshati kishte 27 shtëpi me 139 banorë. Pozita e volitshme komunikuese (afër “Xhadës së Vjetër”), si dhe vendosja e disa familjeve turke në fshat në kohën e Perandorisë Otomane, bënë që Bilaçi të shndërrohej në një vendbanim të rëndësishëm të Luginës së Preshevës. Popullsia e fshatit, si ajo turke, ashtu edhe shqiptare e serbe, bënte jetë qytetare dhe merrej me zeytari dhe tregti. Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Bilaç jetojnë 2,928 banorë rezidentë, shumica shqiptarë, pastaj serbë dhe romë. Nga objektet e standardit shoqëror fshati ka shkollën tetëvjeçare, stacionin shëndetësor, stacionin e veterinarisë, tregun etj. Është qendër e bashkësisë lokale për fshatrat Brodosellë, Novosellë e Poshtme, Negoc dhe Somolicë. (Arsim Ejupi)

BILALLI Ahmet (1974-). Gazetar i sportit. Lindi në Dobrosin të Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Gjilan. Kreu studimet në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Filloi të merret me gazetari nga viti 2000 në të përditshmen “Epoka e re” (gazetar e redaktor i rubrikës sportive). Në të njëjtën kohë ishte korrespondent nga Kosova i portalit sportiv “Albaniasoccer”. Më pas punoi për gazetën ditore “Infopress” dhe më vonë si korrespondent nga Gjilani për gazetën ditore “Tribuna”, si dhe për të përditshmen sportive “Sport”. (Enver Sadiku)

BILALLI Asllan (1952-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Duf, komuna e Gostivarit në Maqedoni. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Gostivar, kurse Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit (1980). Nga viti 1981 deri më 1984 punoi në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë. Po në këtë vit u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik të UP-së, kurse në vitin 1996 ligjërues për lëndën e drejta ndërkombëtare private. Në vitin 2000 po në Fakultetin

Juridik të UP-së mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës dhe u zgjodh profesor asistent dhe më vonë profesor i rregullt për lëndët e drejta ndërkombëtare private, e drejta romake etj. Ka publikuar punime dhe tekste shkencore nga fusha e së drejtës ndërkombëtare private. (Nerxhivane G. Dauti)

BILANCI ENERGJETIK. Një dokument i parashikimit të kërkesës për të gjitha produktet e energjisë në Kosovës për një vit kalendarik. Bilancin e përgatit Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në pajtim me Ligjin për energji dhe me Udhëzimin administrativ mbi rregullat për balancat e energjisë, që aprovohet nga qeveria. Hartimi i bilancit bazohet në bilancet e entiteteve që merren me aktivitete të prodhimit, bartjes, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit dhe shpenzimit të produkteve të energjisë. Të dhënat e përpunuara paraqiten në formatin standard "Eurostat". Këtu jepen të dhënat themelore për të gjitha produktet e energjive primare, energjive të përfituara, importet, eksportet dhe stoqet. Pastaj përfshihen të dhënat për stabilimentet e transformimit të energjive primare në energji elektrike, termike, gazifikim, briketit, ngrohje qendrore, panele diellore, si dhe shkëmbimet e transferet e tyre. Në fund jepen të dhënat për shpenzimin e produkteve finale të energjisë në sektorët ekonomikë, si: amvisëria, industria, shërbimet, transporti dhe bujqësia.

Për parashikimin e rritjes së konsumit të energjisë në Kosovë për vitin 2015 është marrë parasysh rritja e llogaritur e zhvillimit ekonomik për këtë vit, i vlerësuar me 4.3%. Sipas bilancit energjetik të Kosovës për vitin 2015, konsumi total i të gjitha produkteve energjetike parashihet të jetë 1406,06 ktoe. Produktet e naftës në sasi prej 628.61 ktoe ose 44.7%, vazhdojnë të jenë pjesëmarrësit më të mëdhenj në konsumin total, energjia elektrike merr pjesë me 450.74 ktoe ose 32.1%, biomasa me 255.73 ktoe ose 18.2%, thëngjilli me 61.07 ktoe ose 4.3%, ngrohja e përfituar 9.21 ktoe ose 0.7%, energjia diellore me 0.71 ktoe ose 0.1%. Për vitin 2015 është planifikuar që nga të gjitha termocentralet (TC) dhe hidrocentralet (HC) vendore të prodhohet energji elektrike totale në prag të transmisionit në sasi prej 5,890 GWh = 507 ktoe. Për vitin 2016 Kosova importoi një sasi të energjisë bruto (naftë, energji elektrike, thëngjill i biomasës) prej 698 ktoe ose 28% e

shumës totale të nevojave për energji, që është 2,503 ktoe. Prodhimi i thëngjillit për nevojat e termocentraleve dhe për treg ishte në sasi prej 8,400,000 ton. Shpenzimi specifik i thëngjillit në TC "Kosova A" në gjenerator është llogaritur 1.52 ton/MWh, ndërkaq për TC "Kosova B" 1.22 ton/MWh. Për thëngjillin me kapacitet termik specifik prej 7800 kJ/kg, rendimenti termik për TC A është 30.36%, ndërkaq për TC B 37.83%. Shpenzimi vetanë në stabilimentet e transformimit të energjisë është vlerësuar 46.84 ktoe, ndërkaq humbjet në bartje dhe shpërndarje 60.89 ktoe. Shpenzimi i energjisë sipas sektorëve ekonomikë është paraparë si vijon: amvisëri 533 ktoe, industri 320.33 ktoe, shërbime 130.83 ktoe, transport 340.44 ktoe, bujqësi 31.19 ktoe. (Në bilanc energjetik të gjitha llojet e energjisë shprehen me njësinë ktoe (kilo ton oil ekuivalent-kilo ton naftë ekuivalente). 1 ktoe=11.62 GWh). (Ali Hamiti)

BILANCI I PAGESAVE. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar bilanci i pagesave është një pasqyrë statistikore që përmbledh transaksionet ndërmjet individëve dhe organizatave rezidente dhe jorezidente gjatë një periudhe. Komponentët kryesorë të bilancit të pagesave janë llogaria rrjedhëse (me nënkomponentët, si: llogaria e mallrave dhe e shërbimeve, llogaria e të ardhurave primare, llogaria e të ardhurave sekondare), pastaj llogaria kapitale dhe llogaria financiare. Sipas sistemit të kontabilitetit të regjistrimit të dyfishtë, mbi të cilin bazohet bilanci i pagesave, secili transaksion regjistrohet dy herë dhe shuma e hyrjeve të kreditit dhe shuma e hyrjeve të debitit duhet të jetë e barabartë. Llogaria rrjedhëse tregon flukset e mallrave, të shërbimeve, të të ardhurave primare dhe të ardhurave sekondare midis rezidentëve dhe jorezidentëve. Llogaria kapitale tregon regjistrimet e kreditit dhe debitit për asetet jofinanciare jo të prodhuara dhe transfertave kapitale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve. Ajo përfshin transaksionet si për shembull shitja e tokave për ambasadat dhe shitja e lizingjeve dhe licencave si dhe transfertat kapitale, siç është sigurimi i burimeve për qëllime të kapitalit nga ana e njëjës palë, pa ndonjë gjë me vlerë ekonomike si kthim i drejtpërdrejtë ndaj asaj palë. Llogaria financiare tregon përvetësimin dhe shitjen neto të aseteve dhe detyrimeve financiare. Shuma e balanceve në llogaritë rrjedhëse dhe kapitale përfaqëson kreditimin neto

(tepricën) ose huamarrjen neto (deficitin) nga ekonomia me pjesën tjetër të botës. Kjo është konceptualisht e barabartë me bilancin neto të llogarisë financiare. Pra, llogaria financiare mat se si financohet kreditimi ose huamarrja neto nga jorezidentët.

Edhe pse llogaritë e bilancit të pagesave, në parim, janë të balancuara, pabarazitë rezultojnë në praktikë nga të metat në të dhënat burimore ose në procesin e përpilimit. Ky çekuilibër, një tipar i zakonshëm i të dhënave të bilancit të pagesave, është emërtuar “gabimet dhe lëshimet neto” dhe duhet të identifikohet veçmas në të dhënat e bilancit të pagesave. Në Republikën e Kosovës statistikën e bilancit të pagesave përpilohet nga Banka Qendrore e Kosovës, bazuar në standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës karakterizohet me një pozicion mjaft të pafavorshëm të bilancit të pagesave. Në periudhën e pasluftës bilanci negativ tregtar ka arritur deri në 40.1% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB), duke qenë kontribues kryesor i deficitit në llogarinë rrjedhëse, i cili ka arritur në 7.9 % të PBB-së në vitin 2014. Faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë remitancat e bashkatdhetarëve, të cilat arrijnë shumën prej rreth 693,8 milionë euro (12.6% e PBB-së), pastaj shërbimet tregtare me një bilanc pozitiv prej 335,9 milionë euro (6.1% e PBB-së), si dhe kompensimit të punëtorëve jashtë ekonomisë së Kosovës me bilanc prej 200,4 milionë euro (3.6% e PBB-së). Në kuadër të llogarisë financiare, kategoria kryesore përbëhet nga investimet e jashtme të drejtpërdrejta, të cilat në vitin 2014 kishin vlerën 151,3 milionë euro apo 2.7% e PBB-së. (Valentin Toçi)

BILANCI I SUKSESIT. Pasqyrë financiare që mat performancën financiare të subjektit afarist gjatë një periudhe specifike kohore. Kjo performancë vlerësohet duke përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet nga veprimtaritë operuese dhe jooperuese. Për dallim nga bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave përshkruan çfarë ndodh gjatë një muaji, tremujori apo një viti. Ajo përmbledh të ardhurat e krijuara dhe kostot (shpenzimet) e bëra për krijimin e këtyre të ardhurave. Diferenca në mes të ardhurave të krijuara dhe kostove paraqet pjesën e tretë, përkatësisht të ardhurën (ose humbjen) neto apo siç mund të gjendet në pasqyra të ndryshme,

fitimin (apo humbjen). Sipas Standardit Kosovar të Kontabilitetit nr.1, pasqyra e të ardhurave duhet të përfshijë së paku këta zëra: të ardhurat nga veprimtaria, kategoritë themelore të shpenzimeve nga veprimtaria, fitimin apo humbjen nga veprimtaria, kostot financiare, shpenzimet e tatimit në të ardhura, të ardhurat e tjera, zërat e jashtëzakonshëm dhe fitimin apo humbjen neto nga veprimtaria. Ajo bazohet në ekuacionin bazik të kontabilitetit (e ardhura neto=të ardhurat-shpenzimet) dhe tregon pjesën për të cilën ekuiteti i pronarëve ndryshon për të mirë apo për të keq. Së bashku me bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë, formojnë tërësinë bazike të informatave financiare të nevojshme për të menaxhuar një subjekt afarist. Po ashtu quhet edhe bilanci i suksesit, pasqyra e raportimit të fitimit apo edhe pasqyra e fitimit dhe humbjes. (Skender Ahmeti)

BILANCI TREGTAR. Diferenca ndërmjet importit dhe eksportit të produkteve dhe të shërbimeve në një periudhë të caktuar kohore. Në llogaritë kombëtare, bilanci tregtar është pjesë e bilancit të pagesave. Në rastin kur vlera apo sasia e eksportit e kalon atë të importit, themi se vendi ka bilanc pozitiv tregtar, ndërsa kur importet janë më të larta se eksportet, vendi ballafaqohet me deficit tregtar. Bilanci tregtar është një pasqyrë e nivelit të aftësisë konkurruese të ekonomisë karshi vendeve të tjera dhe, kur është pozitiv, kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e brutoproduktit vendor në formë të neto eksportit. Që nga koha e pasluftës, Kosova ballafaqohet me deficit të thellë tregtar, veçanërisht në produkte. Gjatë dekadës së fundit, raporti eksport-import në produkte ka qenë rreth një me dhjetë, pra më tepër se dhjetë herë është importuar në krahasim me eksportet e realizuara. Sot deficitit tregtar i Kosovës është rreth 2,5 miliardë euro. Sa i përket eksportit të shërbimeve situata është krejt ndryshe: në vitet e fundit Kosova ka shënuar vazhdimisht bilanc pozitiv në eksportin e shërbimeve. Në vitet e fundit, niveli i eksporteve tejkalon importet me mbi 300 milionë euro. Ndonëse ka pasur zhvillimeve pozitive në sektorin e shërbimeve, situata nuk ndryshon substancialisht nëse produktet dhe shërbimet merren së bashku, pra edhe më tutje bilanci tregtar mbetet negativ. Arsyet e deficitit të lartë tregtar të Kosovës janë të lidhura me të kaluarën ekonomike dhe

politike të vendit dhe me ngecjen në reformat ekonomike të pasluftës, të cilat së bashku kanë penguar zhvillimin e një sektori privat konkurrues në tregjet e jashtme. (Petrit Gashi).

BIMËT AROMATIKE. Në Kosovë ekzistojnë dhjetëra lloje bimësh aromatike dhe kërkesat për to janë rritur dukshëm. Janë bimë të pasura me komponime organike të avullueshme, të cilat u japin bimëve aromën karakteristike. Këto komponime mund të ekstrahohen nga bimët dhe ekstrakti i fituar është vaj esencial. Bimët aromatike dhe ekstraktet e tyre përdoren për qëllime të ndryshme në industrinë ushqimore, kozmetike dhe aromaterapi. Këto bimë kryesisht u takojnë familjeve: *Apiaceae*, *Asteraceae*, *Lamiaceae*, *Pinaceae*. Ndër llojet bimore aromatike më të njohura të ne janë hormoçi (*Picea excelsa*), rrobulli (*Pinus Heldreichii*), kërleka (*Pinus mugo*), dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), akacia (*Robinia pseudoacaciae*), bliri (*Tilia cordata*), manushaqja (*Viola odorata*), sherbela e zakontë (*Salvia officinalis*), menta djegëse (*Mentha piperita*), arusha mjekësore (*Stachys officinalis*), kimusi (*Thymus vulgaris*), zhumbrica shqiptare (*Thymus albanus*), pelini i zi (*Artemisia vulgaris*) etj. (Bahxhet Mustafa)

BIMËT ENDEMIKE. Flora vaskulare e Kosovës është mjaft e pasur me bimë endemike, endemorelikte dhe subendemike. Në Kosovë janë të pranishme bimë të endemizmit të ri dhe ato të endemizmit të lashtë ose relikte. Të endemizmit të ri janë grupi më i madh i krijuar në periudha të reja gjeologjike, kryesisht në male të larta të Kosovës, ku për shkak të izolimit nuk kanë përhapje të madhe. Të endemizmit relikto janë grup më i vogël dhe paraqesin mbeturinat e florës së lashtë të epokës së terciarit, të strehuara në refugjume të ruajtur deri në ditët e sotme si elemente endemorelikte, siç janë bulgëri, boshtra, llojet e gjinisë *Wulfenia*. Pjesët më të pasura me bimë endemike janë malet e larta të Kosovës dhe tokat serpentinore. Malet e larta të Kosovës llogariten si qendra floristike të endemizmit ballkanik. Në florën e Kosovës është i rëndësishëm grupi i endemikeve lokale, të përhapura vetëm në disa lokalitete (stenoendemitet), si: *Achillea alexandri*, *Aconitum pantheri*, *Aristolochia merxmulleri*, *Centranthus longifolius*, *Cephalaria pastricensis*, *Crocus scardicus*, *Dianthus scardicus*, *Micromeria albanica*, *Potentilla dorfleri*, *Saxifraga scardica*, *Sorbus*



SOLENTANTHUS KRASNIQI

dacica, *Wulfenia bleicicii*. Këtu duhen veçuar llojet e reja për floristikën të zbuluar në trevën e Kosovës, siç është *Solenanthus (Cynoglossum) Krasniqi*, Vrab i përhapur në Pashtrik dhe *Centaurea alberti* Rexh e përhapur në Devë dhe në Golesh. Disa nga endemitet dhe endemoreliktet e Kosovës janë të rëndësishme ndërkombëtare dhe janë përfshirë në regjistrin e kuq të Europës dhe të botës, të karakterizuara me shkallë të ndryshme të rrezikimit. (Feriz Krasniqi)

BIMËT MJEKËSORE. Numri i përgjithshëm i llojeve të bimëve mjekësore në Kosovë është rreth 300. Llojet më të njohura si bimë mjekësore të ne janë: sanëza (*Gentiana lutea*), lulebasani i shpuar (*Hypericum perforatum*), haraqina mjekësore (*Valeriana officinalis*), barpezmi (*Achillea millefolium*), rrush ariu (*Arctostaphylos uva-ursi*), bari i bletës (*Melisa officinalis*), lotzonja (*Convollaria majalis*), latrapeci i madh (*Chelidonium majus*), rigoni i zakonshëm (*Origanum vulgare*), kamomili (*matricaria chamomila*). Mbledhja dhe grumbullimi i bimëve mjekësore në Kosovë ka një traditë të hershme. Vendet më të pasura me lloje të bimëve mjekësore në Kosovë janë malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Gjithnjë e më shumë njerëzit në Kosovë po merren me mbledhjen e këtyre bimëve me përhapje spontane, por dhe po bëjnë kultivimin e tyre. Shumë prej tyre janë edhe përpunues qoftë në formë çaji, qoftë duke përgatitur pomada të caktuara dhe shumë ilaçe të tjera, që përdoren

tradicionalisht në mjekësinë popullore. (Behxhet Mustafa)

BINA Xhemush (1924-2009). Agronom, mekanizator, mësimdhënës universiteti. Lindi në Preshevë, shkollën fillor dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Shkupit (1959). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1967). U zgjodh asistent për lëndët makinat dhe pajisjet bujqësore dhe mekanizimi në blegtori (1961). Kreu specializimin në Bullgari nga lëmi i shkencave bujqësore. Ishte dekani i parë i Fakultetit të Bujqësisë. Si autor dhe bashkautor publikoi punime shkencore dhe profesionale nga lëmi i mekanizimit bujqësor. Mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore dhe ishte bartës i Përkujtimores Partizane të vitit 1941. Pas Luftës ushtroi shumë detyra, funksione politike dhe shtetërore në Preshevë, Gjilan dhe Prishtinë. (Shukri Fetahu)

BINAKAJ Ilir (1954-). Gazetar. Lindi në fshatin Drenoc të Deçanit. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje. Në Sarajevë kreu studimet për gazetari në Fakultetin e Shkencave Politike. Nga viti 1979 zuri punë si gazetar dhe pastaj redaktor në Radiotelevizionin e Prishtinës. Publikoi shkrime kryesisht për bujqësinë në revista dhe gazeta të ndryshme të Kosovës. Gjatë Luftës (1998/99) punoi reporter për agjenci lajmesh të Malajzisë, Iranit, Kuvajtit, si dhe për të përditshme të Sarajevës. Nga viti 2000 rifilloi punë në RTK, si gazetar dhe redaktor i emisioneve për bujqësi dhe fshat. (Shaqir Foniqi)

BINAKU Agim (1955-2018). Gazetar i sportit. Lindi në Carrabreg të Deçanit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë, studioi në Zagreb dhe në Prishtinë. Në fillim (1976) punoi si gazetar i sportit në programin e dytë të Radio-Prishtinës, pastaj redaktor në redaksi të sportit të programit të parë të Radio-Prishtinës, komentator i ndeshjeve të futbollit dhe i ngjarjeve të ndryshme sportive në ish-Jugosllavi dhe jashtë saj, deri në vitin 1990. Më 1994 u bë bashkëbotues dhe kryeredaktor i revistës “Reflekse sportive”, pastaj editor dhe kryeredaktor i revistës “Top sporti” (1995). Në periudhën 1996-2001 ishte gazetar-redaktor i rubrikës së sportit në të përditshmen “Bota sot”, më vonë bashkëpunëtor te “Sporti shqiptar” dhe bashkëpunëtor i gazetës “Sport

plus”. Është i pari gazetar kosovar që mori çmimin mbarëkombëtar “Anton Mazrreku”. Prej vitit 1998 u angazhua si gazetar dhe redaktor i sportit në RTV 21 dhe më vonë (2011) redaktor përgjegjës i informacionit në këtë medium. Edhe për RTV 21 ndoqi ngjarje të rëndësishme sportive vendore dhe ndërkombëtare. (Rifat Gjonbalaj)

BINÇA. Fshat në Anamoravë (komuna e Vitisë), që shtrihet rrëzë shpateve veriore të maleve të Karadakut, në lartësi mbidetare 710 m. Fshati Binçë kishte statusin e bashkësisë lokale që nga vitet ‘50 të shekullit të kaluar, deri në vitin 1999, në të cilën gravitonin fshatrat Kabash, Beguncë, Buzovik, Debëlldeh, Shusht dhe Mjak. Derisa në vitin 1948 në fshat kanë jetuar 742 banorë në 120 ekonomi familjare, në vitin 2011 në Binçë jetojnë 1,127 banorë me gjithsej 184 ekonomi familjare. Popullsia merret me blegtori, lavërtari dhe pylltari. Ka shkollën fillore që funksionon si paralele e ndarë e fshatit Kabash. (Nexhat H. Rexha)

BINISHI Riza (1938-2011). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe abdominal, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1969). Pas diplomimit punoi në Gjakovë dhe pas specializimit në kirurgji të përgjithshme kaloi me punë në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë. Me themelimin e Fakultetit të



RIZA BINISHI

Mjekësisë në Prishtinë u emërua asistent për lëndën e kirurgjisë. Më 1978 mbrojti temën e doktoratës nga fusha e kirurgjisë abdominale dhe u zgjodh docent dhe më pas profesor i ordinuar dhe profesor ordinar i lëndës kirurgji e përgjithshme dhe luftarake. Ishte njëri ndër themeluesit e kirurgjisë abdominale në Qendrën Klinike të Kosovës, për shumë vjet ishte kryeshef i repartit dhe shef i katedrës së kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Gjatë luftës së fundit dha kontribut të çmuar profesional në spitalet ushtarake të UÇK-së në Zonën Operative të Drenicës dhe atë të Llapit, ku për 3 muaj u ofroi ndihmën mjekësore dhe kirurgjikale ushtarëve dhe popullatës civile të kësaj ane. Pas përfundimit të luftës ishte dekan

i Fakultetit të Mjekësisë (2000-2003). Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale. (Avdyl Krasniqi)

BIODIVERSITETI. Hapësira e Kosovës, edhe pse përfshin një sipërfaqe të vogël të Ballkanit, krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe të Europës, dallohet me vlera të larta të biodiversitetit. Kosova është shtëpia e rreth 2,500 llojeve të bimëve lulore, 104 lloje kërpudhash, shumë lloje likenesh, myshqesh, algash, 210 lloje të egra të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave. Biodiversitetin e Kosovës e bën të rëndësishëm prania e një numri të madh të llojeve endemike dhe relikte. (Behxhet Mustafa)

BISLIMI Daut (1945-). Historian. Lindi në Vërban të Vitisë. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa ato të mesme në Gjilan dhe në Beograd. Studimet për histori i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1978), ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mrojti disertacionin e doktoratës (1996). Nga viti 1971 dhe deri në pensionim punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ishte bibliotekar i Institutit. Në periudhën 1999-2010 ishte anëtar i redaksisë së revistës “Gjurmime albanologjike” (seria e shkencave historike). Botoi librat historikë “Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945” (1997), “Azem Morana dhe aktiviteti kombëtar i ONDSH-së në Maqedoni” (bashkautor, 1998), “Bibliografi e punimeve historike të publikuara në Kosovë gjatë viteve 1946-1998” (2006). Botoi edhe një sërë studimesh historike për periudhën midis dy luftërave botërore dhe Luftën e Dytë Botërore në revista të ndryshme shkencore dhe mori pjesë me kumtesa në simpoziume, konferenca dhe tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Fitim Rifati)

BISLIMI Ramadan (1938-2011). Gazetar. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Normalen në Prishtinë. Rreth një dekadë punoi mësues, e pastaj u bë korrespondent i gazetës “Rilindjes” nga Gjilani, ndërsa më vonë kaloi me punë në redaksinë qendrore, në Prishtinë. Shkroi raporte për punën e organizatave shoqërore-politike të Kosovës, si dhe për ngjarje dhe zhvillime të tjera në vend. Kreu edhe detyra të tjera me përgjegjësi në redaksinë e “Rilindjes”, ku punoi mbi tri dekada. (Zenun Çelaj)

BISLIMI Rexhep (1966-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Stubëll të Poshtme të Vitisë. Ishte komandant dhe themeluesi i bërthamës së parë të UÇK-së për Ferizaj dhe rrethinë. Në korrik të vitit 1988, në Prishtinë u dënua me dy vjet burg. Më 14 prill 1993, në fshatin Kollare të Kërçovës (Maqedoni) mori pjesë në konsultën e përgjithshme të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), ku delegatët morën vendim për formimin e krahut ushtarak të LPRK-së. Më 1996 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi me detyrë për formimin dhe organizimin e UÇK-së për Ferizaj. Në shtator të vitit 1997 u emërua komandant i njësitit të Ferizajt. Në korrik të vitit 1998 u kidnapua nga policia serbe dhe u torturua dy javë rresht. Më 19 korrik, në gjendje kome, u dërgua në Spitalin e Prishtinës, ku vdiq më 21 korrik 1998. (Ruzhdi Jashari)

BISLIMI Xhevat (1961-). Veprimtar politik, gazetar. Lindi në Vërban të komunës së Vitisë. Kreu shkollën e mesme në Viti. Ishte student i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, kur u arrestua dhe u dënua për veprimtari armiqësore (1982). Më 1989 emigroi në Austri, pastaj në Francë, ku qëndroi për disa vjet. Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ishte anëtar i Këshillit Qendror të Fondit “Vendlindja thërret” dhe përfaqësues politik i UÇK-së për Francë. Ishte gazetar dhe anëtar i redaksisë së gazetës “Zëri i Kosovës”. Mori pjesë në themelimin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ishte anëtar i këshillit drejtues dhe i kryesisë së kësaj partie. Më 2014 u largua nga PDK-ja dhe iu bashkëngjiti partisë “Nisma” dhe më pas “Vetëvendosjes”. Pas luftës ishte kryeredaktor dhe drejtor i Agjencisë së Lajmeve “Kosovapress”. (Halim Emërllahu)

BISLIMI Mehmet (1958-). Veprimtar politik, publicist. Lindi në fshatin Prekaz i Epërm në Drenicë. Studoi për kimi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1981 u dënua me burg për aktivitet politik ilegal. Pas daljes nga burgu (1986), veprimtarinë politike e vazhdoi në radhët e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK-LPK), anëtar i së cilës ishte që nga viti 1987 dhe më pas pjesëtar i celulave të para të UÇK-së në Drenicë. Në vitin 1994 emigroi në Zvicër, ku u angazhua në Fondin

“Vendlindja thërret”. Pas themelimit të PDK-së, për dy mandate ishte kryetar i degës së kësaj partie në Zvicër. Botoi shkrime të ndryshme në gazeta dhe revista brenda dhe jashtë Kosovës. Disa vjet ka shkruar për gazetën “Zëri i Kosovës”. Ka botuar disa libra me poezi dhe publicistikë: “Fjalë dhe gurë” (2003), “Këtu i thonë Drenicë” (2004), “Ironi e verdhë” (2005), “Stinë e vonuar” (2008), “Shkrime publicistike” (2009), “Lirikat e fjetura” (2013) etj. Jeton dhe vepron në Zvicër. (Ruzhdi Jashari)

BISTRICA E DEÇANIT. Lumë në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit. Ndryshe njihet edhe me emrin Lumëbardhi i Deçanit. Është degë e djathtë e lumit Drini i Bardhë. Buron në Bjeshkën e Roshkodolit, në vendin e quajtur Tëdel i Lumëbardhit, në lartësinë mbidetare 2,130 m. Lumi rrjedh përgjatë luginës poligjenetike-fluvioglaciale, në të cilën edhe sot vërehen sedimentet glaciale, morenat. Shtrati i lumit është thelluar në formacionet e paleozoit dhe mesozoit. Në pjesën e epërme, lugina është e parakushtëzuar nga kontakti litologjiko-tektonik, ndërsa në pjesën e poshtme është thelluar në formacionet e pliocen-kuaternarit. Ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 278 km², gjatësi 53 km dhe prurje mesatare në grykëderdhje 5.6m³/s. Ushqehet me ujë nga reshjet e shiut dhe shkrija e borës. Sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin 1,178 mm, që është pellgu lumor me më shumti reshje në Kosovë. Ka potencial hidroenergetik. Pjerrtësia mesatare e shtratit të lumit është 36 m/km. Në rrjedhën e epërme të tij është ndërtuar hidrocentrali “Kozhnjer” me fuqi 6.4 MW. Në pjesën fushore, uji i Bistricës së Deçanit përdoret për ujitjen tokave bujqësore dhe për furnizimin me ujë të liqenit artificial të “Radoniqit”. Afër Mrasorit i bashkohet Drinit të Bardhë. (Selim Qevani)

BISTRICA E LLOQANIT. Lumë në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, buron në Bjeshkët e Nemuna dhe rrjedh edhe përgjatë Rrafshit të Dukagjinit. Ndryshe njihet me emrin Lumëbardhi i Lloqanit. Është degë e majtë e lumit Erenik. Buron në Bjeshkën e Junikut dhe formohet nga bashkimi i rrjedhjeve që vijnë nga shpatet e Kurvallës, Dervishkomit dhe Stanishtës së Zogut, në lartësi 2,100 m. Ujëmbledhësi ndërtohet nga formacionet e paleozoikut, gëlqerorët e triasit. Lumi ka gjatësi

24 km dhe e ka të thelluar shtratin në luginën poligjenetike-fluvioglaciale, ku hasen edhe sedimentet akullnajore, morenat. Derdhet në lumin Erenik, afër Gjakovës. Ujërat e Bistricës së Lloqanit në pjesën fushore përdoren për ujitjen e tokave bujqësore. (Selim Qevani)

BISTRICA E PEJËS. Lumë në pjesën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit. Ndryshe njihet me emrin Lumëbardhi i Pejës. Është degë e djathtë e lumit Drini i Bardhë. Buron rrëzë



RRJEDHË E BISTRICËS NË PEJË

malit Starac, me emrin e lumit Bjelluhë, në lartësi mbidetare 2,243 m mbi nivelin e detit. Ka sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 505 km², gjatësi 63 km dhe prurje mesatare të ujit në grykëderdhje 8.2 m³/s. Prurjet maksimale janë në muajin maj, kurse minimalet në muajin gusht. Ka regjim nivalo-pluvial. Sasia mesatare vjetore e reshjeve në pellg është 1,105 mm, pjerrtësia e shtratit të tij është 30 m/km. Pjesa e epërme e rrjedhës është malore, në të cilën lumi ka prerë formacionet kompakte të paleozoikut dhe ka thelluar luginën e tij me shpate të pjerrëta, pragje dhe ujëvara. Gjatë periudhës së fundit të akullzimit ishte nën akullnajë dhe, pas tërheqjes së saj, thelloi grykën e Rugovës. Pasi lë grykën e Rugovës, Bistrica e Pejës kalon në Rrafshin e Dukagjinit dhe merr tiparet e një lumi fushor, kalon përmes qytetit të Pejës dhe afër fshatit Grabanicë e Poshtme derdhet në Drinin e Bardhë, në lartësinë mbidetare 365 m. (Selim Qevani)

BISHA Asllan (1945-). Shkrimtar. Lindi në Lisën, komuna e Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në Shtodër, ndërsa të mesmen dhe shkollën e lartë për gjuhë e letërsi shqipe në Prizren. Një kohë punoi si përkthyes në Kuvendin Komunal

të Ulqinit, pastaj mësimdhënës i gjuhës shqipe po në Ulqin. Ishte bashkëpunëtor i gazetës “Rilindja” dhe i Radiotelevizionit të Kosovës. Njëri nga themeluesit e shoqatës “Art Club” në Ulqin (1990), mori pjesë në organizimin e aktiviteteve letrare dhe kulturore shqiptare në Mal të Zi. Botoi tregime, novela e romane: “Valët e detit” (1986), “Nusja e detarit” (tregime), “Dashuri në stinën e verës” (1998), “Dashuri te palma” (2007), “Frikë dhe dashuri në Barbanë” (2010), “Ankthi i pritjes” (2010), “Dashuri në stinën e qershivës”, (2013), “Zonja nga kryeqyteti” (2014), si dhe libra për fëmijë, kryesisht në prozë: “Net peshkimi” (1998), “Dasma e peshqve” (1996) dhe “Ufo në Barbanë” (2015). Krijimtaria e tij është përfshirë në panorama dhe zgjedhje të autorëve shqiptarë në Mali të Zi, botuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën malazeze. (Haxhi Shabani)


BISHTAZHINI. Fshat në komunën e Gjakovës, rreth 7 km në juglindje të qytetit. Shtrihet në lartësi mbidetare 326-361 m, në rrugën Pejë-Gjakovë-Prizren, përkatësisht në bregun e djathtë të lumit Erenik. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe të zonës kadastrale prej 310 ha, nga e cila 20% janë ara, 30% livadhe, 30% pyje. Popullsia merret kryesisht me kultivimin e grurit, patates dhe bimëve foragjere. Një numër i konsiderueshëm i banorëve punon dhe jeton jashtë Kosovës. Është vendbanim i vjetër, në të cilin janë gjetur mbetje të kulturës materiale të periudhës romake, ndërsa jo larg tij gjendet lokaliteti i vjetër i Gradishit. Si vendbanim i hershëm, Bishtazhini përmendet në kartën e Manastirit të Prizrenit të vitit 1348. Në vitin 2011 kishte 429 banorë, ndaj 128 banorëve sa kishte në vitin 1921. Është qendër lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Marmull, Smaq, Ujëz, Fshaj dhe Kushavec. Ka shkollë 9-vjeçare, shkollë të mesme, qendër shëndetësore, disa njësi tregtare etj. (Qerim Kastrati)

BIZANTI. Fillimisht me këtë emër quhej qyteza në grykë të Bosforit. Legjenda e thotë se këtë qytezë e ngriti mbreti Bizas (997 p.e.r.). Supozohet se ky emër ishte me origjinë trakase ose ilire. Pas pushtimit romak të qytezës (173 p.e.r.), emri i saj mori formën e latinizuar, Bizantium. Bizant quhej edhe monedha e artë dhe e argjentë e Perandorisë Lindore Romake, e cila qarkulloi përgjatë mesjetës në të gjitha

shtetet e Europës së atëhershme. Perandori romak me origjinë dardane, Konstandini i Madh (306-337) e rindërtoi qytezën Bizant dhe e ktheu në një qytet të madh (324-330), i cili u quajt qyteti i Konstandinit (Konstandinopolis), Konstandinopojë. Perandori Teodos (379-395) në shtratin e vdekjes e ndau Perandorinë Romake (395) midis dy djemve të tij: Arkadit (395-408) ia dha pjesën lindore dhe Honorit (395-423) pjesën perëndimore. Ndarja u mendua si një zgjidhje praktike për administrimin më të suksesshëm të territoreve të gjera të perandorisë, e cila shtrihej nga Anglia, Franca e Gjermania e deri në Spanjë, Afrikë të Veriut, Arabi, Mesopotami e në Detin e Zi. Pjesa perëndimore e perandorisë nuk u përballoi dot sulmeve të vazhdueshme të fiseve gjermane dhe, për rrjedhojë, u shpërbë përfundimisht më 476. Ndërkaq, pjesa lindore vazhdoi jetën edhe 1,000 vjet të tjera. Kjo perandori, ndonëse mbajti emrin zyrtar Perandoria Romake (Roman Imperium), kishte shumë pak gjëra të përbashkët me të. Ajo ishte një perandori amalgame, me kulturë helenistike e me ndikim oriental, sidomos të religjionit të krishterë ortodoks, me ndikim të ndjeshëm të Rusisë. Perandoria Romake Lindore në historiografi njihet me emrin Perandoria Bizantine, që iu dha nga enciklopedistët francezë në shek. XVIII. Bizanti i përballoi me sukses vështirësitë në rrafsh të brendshëm dhe të jashtëm, falë reformave të perandorëve Diokleciani (284-305) dhe Konstandini i Madh (306-337), sistemit të reformave të mëvonshme administrative dhe sistemit ekonomik-ushtarak të temave. Ky sistem kishte bazën te temat (shek. VII-VIII), të cilat fillimisht përbënin “tampon zona”, të ngritura kundër pushtimit arab në Azi të Vogël, i mbështetur në sistemin e administrimit ushtarak, që gjeti aplikim më pas në të gjithë perandorinë. Falë këtij elementi të ri, Bizanti mbijetoi sulmet barbare dhe më pas ato sllave, longobarde, arabe etj., si dhe shmangu rrezikun që i kërcënohej nga Karli i Madh, të cilin papa Leoni III (795-816) e shpalli perandor romak (800), me synim zhbërjen e Bizantit. Bizanti mbijetoi edhe krizën e ikonave, sulmet bullgare, hungareze etj. Pasi koha e fuqizimit politik e kulturor dhe shtrirja e ndikimit të ndërsjellë politik me Rusinë. Bizantin e tronditi më pas “Skizma e Madhe” (1054) dhe sidomos Lufta e

Katërt Kryqtare, që pati si rrjedhojë pushtimin e Konstandinopojës (1204) nga perëndimorët (latinët) dhe formimin e Perandorisë Latine (1204-1261). Në këto rrethana, rolin e Bizantit e mori Perandoria e Nikesë (Azi e Vogël), e cila më 1261 ia doli ta çlirojë Konstandinopojën nga latinët dhe t'i kthejë territoret e pushtuara. Por, më pas, në shek. XIII-XV, perandoria u kthye në një shtet dytësor, të cilin përbrenda e tronditën luftërat civile dhe, nga jashtë, sulmet gjithnjë më të shpeshta të Perandorisë Osmane. Pas rrethimit të gjatë, më në fund kryeqyteti i Bizantit, Konstandinopoja, u pushtua nga osmanët (1453). Shqiptarët gjatë sundimit bizantin përmenden me emrin Albanoi, Albanitai, Arbanitai, Arbanensis dhe Arbanas dhe vendi i tyre quhej Arbanum, Albanum e Raban. Ata shtriheshin afërsisht në trojet e sotme shqiptare dhe një kohë ishin pjesë e Komonveltit Bizantin. Studiuesit shqiptarë dhe të huaj kanë argumentuar se ata ia dolën të ruanin identitetin e tyre etnik. Ishin të organizuar në bashkësi territoriale dhe formacione politike, me udhëheqësit e tyre në krye. Nga shek. IX trevat e tyre u përfshinë në sistemin e temave, e më pas fisnikëria arbërore zuri vend në administratën bizantine me titujt e lartë, si arkondë, patricë, sevastë e panhisevastë. Herë pas here arritën të dilnin nga Komonvelti Bizantin, siç ishte rasti me Principatën e Arbrit (1190-1215). Ilirio-arbrit ishin të pranishëm në Kosovë e në trevat përreth gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të Perandorisë së Bizantit. (Ramiz Abdyli)

BIZMARK Oto fon (Otto von Bismarck) (1815-1898). Themelues dhe kancelar i parë i Perandorisë Gjermane, konservator. Lindi në Shonhausen, Mbretëria Prusiane. Studioi



OTO FON BIZMARK

shkencat juridike në Universitetin e Gottingenit, Mbretëria e Hannoverit, si dhe në Universitetin e Berlinit. Në vitin 1847 hyri në parlament. Në periudhën 1851-1862 ishte ambasador në Frankfurt, Paris dhe Shën Peterburg. Në vitin 1862 u caktua kryeministër i Prusisë dhe iu kushtua tërësisht bashkimit gjerman. Për të vendosur fuqinë prusiane në Europë dhe për të bashkuar vendin, ai zhvilloi dhe fitoi tri

luftëra: me Danimarkën (1864), me Austrinë (1866) dhe me Francën (1870-1871). Më 1871 u emërua kancelar i Perandorisë Gjermane. Në vitin 1873, me kontributin e tij të drejtpërdrejtë, u lidh marrëveshja midis Gjermanisë, Rusisë dhe Austro-Hungarisë, e njohur si "Lidhja e tre perandorëve". Në vitin 1878 kryesoi Kongresin e Berlinit. Në vitin 1882, gjithashtu me kontributin e tij, u nënshkrua Aleanca Trepalëshe (Gjermani, Austro-Hungari, Itali), ndërsa më 1890 u detyrua të japë dorëheqjen si kancelar. Ai është i njohur për diplomacinë e realpolitikës. Shfrytëzoi me mjeshtëri ekuilibrin e forcave për t'i siguruar Gjermanisë një zhvillim paqësor dhe pozitën e njërës prej fuqive kryesore në Europë. Ndoqi politikën e izolimit të Francës dhe të marrëdhënieve miqësore me të tjerët. Ishte kundër implikimit ushtarak të Gjermanisë në Ballkan. (Islam Lauka)

BJELIQ Slobodan (Slobodan Bjelić) (1949-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universitar. Lindi në Staro Gradsko, komuna e Lipjanit. Kreu studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1972). Pas diplomimit u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik (1973), më pas kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Beogradit. Mbrojtiti disertacionin në UP (1982) dhe në vitet vijuese avancohet në titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor (1993) për lëndët instalimet elektrike të tensionit të ulët, shndërruesit energjetikë etj.. Bëri specializime profesionale në Moskë dhe në Pragë. Fushë e veprimtarisë së tij shkencore ishte elektroenergjetika, matjet elektrike, mbrojtja rele, rrjetet elektrike, instalimet elektrike dhe shndërruesit energjetikë. Si autor dhe bashkautor botoi një numër punimesh shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2001 punon në Fakultetin e Shkencave Teknike në Mitrovicë. (Isuf Krasniqi)

BJESHKËT E NEMUNA. Kompleks i madh dhe i lartë malor (me maja malore mbi 2,000 -2,500 m lartësi) në pjesën perëndimore të Kosovës. Shtrihen edhe në Mal të Zi (Plavë e Guci) dhe në Shqipërinë Veriore (Alpet Perëndimore). Përbëhen nga rreshtet paleozoike, shkëmbinjtë magmatikë (granite, diorite, gabbro etj), shkëmbinj karbonatikë të triasikut e jurasikut, formacioni diabaz-strallor, brekçiet,




PEIZAZH I BJESHKËVE TË NEMUNA

konglomeratet etj. Karakterizohen nga një ndërtime të ndërlukuar tektonik, me rrudhosje, thyerje e mbihijje tektonike të konsiderueshme. Emri “Bjeshkët e Nemuna” lidhet me tiparet më karakteristike gjeografike të tyre: natyra e ashpër, relievi i thyer karstik dhe vështirë i kalueshëm, mungesa e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore, klima shumë e ashpër dhe përqësimi i papritur i motit, shpeshherë me pasojë në njerëz, mungesa e rrugëve, vështirësitë e jetesës etj. Ky emërtim më vonë u mor nga sllavët dhe u përkthye në “Prokletije”. Emërtimi Bjeshkët e Nemuna, në studimet e gjeografëve dhe në përdorimin e përgjithshëm shpeshherë zëvendësohet me emrin Alpet Shqiptare. Bjeshkët e Nemuna karakterizohen me reliev të lartë alpin dhe me natyrë të ashpër, me reliev të thepisur, me kreshta të ngushta, por edhe me kurrizet e sheshta, të gdhendura nga erozioni dhe akullnajat.

Lugina e Bisticës së Pejës i ndan Bjeshkët e Nemuna të Kosovës në pjesën veriore dhe atë jugore. Në pjesën veriore bëjnë pjesë Zhlebi (2,365 m), Hajla (2,400 m), Rusolia (2,382), Shtedimi (2,272 m), Pakleni (1,376) etj., të cilat karakterizohen me forma relievore të akullzimeve, karstike e lumore dhe me shpate më të buta. Në drejtim të fushëgropës së Dukagjinit këto male ulen dora-dorës, duke kaluar në kodrinat e Podgurit të Pejës, me lugina të reja e të gjera. Pjesa jugore përbëhet nga maja të larta e shpate të thikta, gryka dhe lugina të thella e të ngushta, me forma të shumta të krijuara nga

akullzimi i kuaternarit (cirqe, lugina e liqene akullnajore, morena) dhe erozioni lumor. Në pjesën jugore bëjnë pjesë malet e Junikut (2,265 m), të Strellcit (2,377 m), të Kopranikut (2,460 m), Mali i Lumëbardhit (2,522 m), Gjeravica (2,656 m), maja më e lartë e Kosovës dhe e dyta e gjithë Bjeshkëve të Nemuna, pas Jezercit (2,694 m), që gjendet në territorin e Shqipërisë). Në rrjedhën e sipërme të Bisticës së Pejës gjendet gryka e Rugovës, me morfologji të veçantë dhe natyrë alpine të bukur. Lumi Bistrica ka çarë disa qindra metra thellë luginën e vet, mbi të cilën ngrihen shpate gëlqerore vertikale. Në rrëzën e Bjeshkëve të Nemuna gjendet edhe ujëvara e Drinit të Bardhë, uji bie nga 30 m lartësi. Kështu, pyjet madhështore dhe burimet me ujëra të ftohta kanë krijuar peizazhe shumë të bukura. Bjeshkët e Nemuna kanë pasuri të madhe ujore. Këtu buron Drini i Bardhë, me degët e tij: Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, Bistrica e Lloqanit, Ereniku etj. Në Gjeravicë gjenden disa liqene akullnajore, të krijuar në cirqe (Liqeni i Madh dhe Liqeni i Vogël, në lartësi 2,320, përkatësisht 2,360 m). Liqen tjetër është ai i Kuqishtës dhe i Drelajve. Në rrëzën e Bjeshkëve të Nemuna burojnë gurra të fuqishme karstike: Gurra e Radavcit, e Vrellës, e Istogut etj. Klima e Bjeshkëve të Nemuna është alpine me dimër të gjatë e të ashpër, me reshje të shumta bore dhe verë të shkurtër dhe të freskët. Bjeshkët e Nemuna janë një nga zonat më të pasura me bimësi në Ballkan (shumë nga këto janë endemike). Në rrëzë të maleve paraqitet dushku, gështenja e ahu dhe, duke shkuar më lart renditen halorët, kërleka (pishë gërmushë), zona e livadheve alpine me barëra e lule të shumëllojshme, ndërsa majat e larta (mbi 2,400 m) janë të zhveshura nga bimësia. Bota e kafshëve të egra është gjithashtu e pasur dhe e shumëllojshme (ariu i murrmë, rrëqebulli, dhelpra, derri i egër, dhia e egër, kaprolli, pula e egër, thëllëza e malit etj.). (Vahdet Pruthi)

BLAKAJ Mustafë (1937-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kovragë, komuna e Istogut. Shkollimin bazë e bëri në vendlindje, pastaj kreu Shkollën Normale në Prishtinë dhe studimet universitare në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa specializimin për marrëdhëniet ekonomike me botën e jashtme në Paris. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, doktoratën e mbrojti në Universitetin



MUSTAFË BLAKAJ

e Prishtinës. Punoi në disa shkolla të Kosovës, si në Istog, në Vushtrri, në Mitrovicë dhe në disa organizata të tjera, përfshirë Odën Ekonomike të Kosovës, Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror, Institutin Ekonomik të Kosovës, Këshillin Qendror për Financim të Kosovës. Në Universitetin e Prishtinës mbajti ligjërata të rregullta nga fusha e financave dhe e ekonomisë së ndërmarrjeve. Publikoi shumë punime shkencore dhe profesionale dhe është autor i tre teksteve universitare “Ekonomia e ndërmarrjes”, “Teoria e shpenzimeve” dhe “Mikroekonomia”, si dhe i një numri analizash dhe ekspertizash financiare, recensioneve shkencore të teksteve shkollore e universitare, të magjistraturave e të doktoratave. Mori pjesë në seminare, simpoziume dhe konferenca shkencore me referate e kumtesa në gjuhën shqipe dhe kroate. Mori pjesë në hulumtimin dhe përpilimin e tekstit ekonomik për “Grupin e Unitetit” për bisedimet e Vjenës lidhur me statusin e Kosovës. (Florentina Xhelili-Krasniqi)

BLAKAJ Sejdi (1957-). Atlet. Lindi në Vrellë të Istogut. Mbaroi Fakultetin Juridik në Prishtinë. Karrierën sportive e nisi në disa sporte, por nga viti 1979 u përcaktua për atletikë. Në vitin 1980 në Prizren zuri dy vendet e para në hedhjen e gjyles dhe të diskut. Gjatë periudhës 1980-2015 fitoi 25 tituj të kampionit të Kosovës në gjyle dhe 35 tituj në disk. Mban dy rekorde të Kosovës: në gjyle 14.82 m dhe në disk 42.60 m. Në vitet 1985 dhe 1986 në garat ndërkombëtare të mbajtura në Stamboll të Turqisë fitoi dy herë vendin e parë në disk. Në vitin 2008, në Tivar të Malit të Zi, në Kampionatin e 18-të Ballkanik të veteranëve (13 shtete pjesëmarrëse) fitoi dy medalje të arta, në gjyle dhe në disk. Në po këtë vit, në Lojërat e 6-ta të vendeve të Detit të Zi në Stamboll fitoi medaljen e argjendtë në gjyle. Vazhdon të jetë trajner i shumë atletëve në dy disiplina teknike (gjyle dhe disk) të klubit atletik “Besë” dhe “Rugova”, si dhe i përfaqësueses së Kosovës. (Rifat Gjonbalaj)

BLAKAJ Skënder (1945-). Gazetar. Lindi në Llukac të Istogut. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Pejë, studimet për



SKËNDER BLAKAJ

gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare i vijoi në Zagreb. Publikoi tekste autoriale në disa revista dhe gazeta. Nga viti 1974 e deri në mars 1981 ishte gazetar dhe redaktor i kulturës në Televizionin e Prishtinës, ku realizoi dokumentarët për arbëreshët e Italisë dhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit me rastin 100-vjetorit. Bëri një sërë dramatizimesh dhe skenarësh, ndër të cilët edhe skenarin për film televiziv “Tre vetë kapërcejnë malin” (1980). Pas vitit 1981 iu ndalua paraqitja në medie. Në vitet ’90 u përfshi në organizimin politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në të cilën gjatë viteve 1991-1994 ishte sekretar i përgjithshëm. Në vitet 1999-2003 ishte kryeredaktor i revistës mujore “Ekskluzivë”, ndërsa në vitet 2006-2010 kryeredaktor i revistës mujore “Albanica”. Është autor i librave: “Skënderbeu/Scanderbeg” (2006), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” (2013), “Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (bashkautor) (2014) etj. (Shefqet Rexhepi)

BLAKAJ Skyfter (1979-). Gazetar, komentator i sportit. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës. Në fillim punoi si gazetar në Radio “Urban FM”, më pas si gazetar dhe komentator i sportit në Radiotelevizionin e Kosovës. Për disa vjet qe edhe gazetar dhe moderator në redaksinë e lajmeve të “Kohavisionit” (KTV). Ka komentuar ngjarje të ndryshme sportive, si: atletikë, not, futboll, basketboll, volejball, boks etj., të cilat janë transmetuar nga KTV-ja, përfshirë edhe ngjarje të rëndësishme sportive nga vendi dhe arena ndërkombëtare. (Ejup Llumnica)

BLAKAJ-KADA Zana (1949-). Gazetare. Lindi në Istog. Shkollën fillore e mbaroi në Istog, Normalen në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi mësimdhënëse në Istog, pastaj qe nga nëntori i vitit 1974 punoi gazetare në Televizionin e Prishtinës, në redaksinë e programit për bujqësi dhe fshat, për të vazhduar më pas në redaksinë dokumentare. Realizoi një sërë

emisionesh për gruan shqiptare në Kosovë. Në vitin 1998 ishte korrespondente nga Prishtina e gazetës “Albania” të Tiranës. Nga nëntori i vitit 2000 punoi gazetare në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), gjithnjë me tema për gruan. (Ibrahim Berisha)

BLAKÇORI Veli (1955-). Pikturor, skulptor, ilustrator. Lindi në Letanc të Podujevës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Podujevë, ndërsa Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Disa vjet punoi mësimdhënës i artit në shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë, më vonë ka qenë karikaturist në gazetat “Rilindja” dhe “Zëri”. U dallua sidomos me portretet-karikatura, në të cilat shquhet një kreativitet i veçantë. Ekspozita të pavarura pati në Prishtinë (1981, 1985, 2002 dhe 2005) dhe në Grozhan, Kroaci (1981). Është fitues i disa çmimeve. Më 1983 mori çmimin për vizatim në ekspozitën e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës në Prishtinë, në vitin 1998 çmimin për pikturë në ekspozitën e po kësaj shoqate, kurse në vitin 1999 mori çmimin e Simpoziumit Ndërkombëtar për Skulpturë në Antalia (Turqi). (Bislim Aliu)

BLAKU Murat (1942-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Podujevë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Po këtu i kreu edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe (1966). Studimet pasuniversitare i ndoqi në Beograd, ndërsa temën e magistraturës e mbrojti në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Tezën e disertacionit të doktoratës për ndikimin e shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës e mbrojti gjithashtu në Prishtinë (1989). Punoi si asistent në Fakultetin e Filologjisë nga viti 1968, e më vonë si ligjërues i lëndës leksikologji shqiptare. M. Blaku botoi studime e artikuj të ndryshëm për shqipen, për ndikimet e saj në serbishten e Kosovës, për historinë e shqipes letrare. Botoi dy libra me studime gjuhësore: “Roli i revistës ‘Albania’ në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe” (2007) dhe “Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës: sipas materialeve gjuhësore të botuara” (2010). (Agnesa Hasimja)

BLAKU Sadri (1847-1910). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në Podujevë. Mori pjesë aktive si luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe i Lidhjes së Pejës. Nga viti 1901 e deri në

rënien e tij mori pjesë në të gjitha kuvendet dhe tubimet që u mbajtën në Llap, Gallup, Artakoll, Vushtrri, Shalë të Bajgorës, Dukagjin etj. Ishte njëri nga themeluesit dhe anëtar i shtabi të kryengritjes së vitit 1904, bashkë me Islam Ukë Bulliqin, Sahit Sekiraqën, Nezir Xhakën etj. Organizoi sulmin kundër forcave osmane në Mreqez më 6 prill 1906, përkrahu alfabetin shqip të Kongresit të Manastirit etj., organizoi Kuvendin e Popovës, më 26 dhjetor 1909, si dhe kryengritjen antiosmane që filloi më 4 prill 1910. Organizoi dhe mori pjesë edhe në Kuvendin e Dumnicës, ku u ndanë armët për kryengritës, në Kuvendin e Letancit etj. (Salih Salihu)

BLEGTORIA. Njëra nga degët kryesore të bujqësisë, që përfshin mbarështimin e gjedhit, të bagëtive të imëta, njëthundrakëve, buallicave, të shpendëve shtëpiakë dhe të bletëve. Blegto-



TUFË DHENËSH NË KULLOTAT E KOSOVËS

ria siguron ushqimet me origjinë shtazore dhe paraqet njërin nga veprimtaritë më të rëndësishme, me të cilat merret njeriu. Në kushtet e prodhimitarisë së sotme, prodhimi i ushqimit të mjaftueshëm blegtoral, me cilësinë përkatëse, me leverdi ekonomike dhe i pranueshëm nga aspekti ekologjik është një punë e ndërlikuar. Kosova karakterizohet me ferma të vogla blegtorale, me kushte jo të mira higjienike dhe zooteknike. Fermat komerciale dhe disa nga fermat gjysmëkomerciale kanë kushte më të përparura për mbarështim. Pjesa më e madhe e sektorit të blegtorisë është prodhimi i gjedheve (rreth 59%), pasuar nga sektori i ripërtypësve të vegjël (dele dhe dhi) me 28%. Shpeztaria dhe derrëria kanë pjesëmarrje më të vogël. Nënsektorët e tjerë blegtoralë në Kosovë janë akuakultura dhe bletaria. Nevojat për

qumësht, mish dhe produkte të tjera blegtorale janë shumë të mëdha, pasi nga pasojat e luftës së fundit fondi i bagëtisë është dëmtuar për më shumë se 50%. Në dekadën e fundit vërehet një rritje e dukshme e gjithë fondit blegtoral, sidomos te gjedhet dhe pulat. Fondi blegtoral në Kosovë sillet në këta parametra: gjedhe rreth 400 mijë krerë; bagëti të imëta rreth 120 mijë; buallica rreth 500 krerë; derra rreth 70 mijë krerë; njëthundrakët rreth 10 mijë; shpendët rreth 2 milionë e gjysmë; bletë rreth 80 mijë koshere. Ky sektor është kërkues vazhdimisht rreth përmbushjes së standardeve të reja higjienike, mjedisore, të mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë së ushqimit. Vlerësohet se në Kosovë janë mbi 83,000 ferma që mbarështojnë kafshë blegtorale, shumica e tyre janë të vogla, kryesisht ekzistenciale dhe gjysmekzistenciale. Duke pasur parasysh nivelin e të ushqyerit, stallat, higjienën dhe organizimin e gjithëmbarsuem në fermë, mund të thuhet se në Kosovë dominon forma ekstensive dhe gjysmintensive e mbarështimit të kafshëve.

Gjithsesi në bujqësi, e posaçërisht në blegtori, arritja e rezultateve prodhuese sa më të larta është bërë e mundur me krijimin e racave dhe linjave të reja me potencial gjenetik të lartë prodhues. Përveç disa racave të gjedhit të specializuara për prodhim qumështi dhe prodhimin të pulave në fermat komerciale, që kryesisht mbarështojnë raca hibride me rendiment të lartë, llojet e tjera të kafshëve në Kosovë përfaqësohen kryesisht nga racat e prodhimtarisë së dyfishtë. (Hysen Bytyçi)

BLER Toni (Anthony Charles Lynton Blair) (1953-). Kryeministër i Britanisë së Madhe. Lindi në Edinburg (Skoci). Kreu shkollën e muzikës në Durham (1961-1966). U regjistrua në Akademinë e pavarur Fettes College në Edinburg dhe kreu studimet për jurisprudencë në kolegjin St. John të Oksfordit. Më 1975 bëhet anëtar i dhomës së avokatëve në Londër. Më 1975 iu bashkua Partisë



TONI BLER

Laburiste. Nga viti 1983 e deri më 2007 ishte anëtar i Parlamentit të Sedgfieldit. Kryetar i Partisë Laburiste në periudhën 1994-2007 dhe kryeministër i Britanisë

së Madhe (1997-2007). Gjatë krizës britanike-irlandeze më 1998, T. Bler arriti paqen dhe përfundimin e krizës përmes marrëveshjes. Luajti rol të rëndësishëm në Luftën e Kosovës gjatë viteve 1997-1999. Kërkojti ndërhyrjen ushtarake nga forcat e NATO-s dhe planifikoi që, nëse NATO nuk ndërhynte ushtarakisht, do të krijohesh një aleancë amerikane-britanike për ndërhyrje ushtarake në Kosovë. Ishte mbështetës i idesë për ndërhyrje tokësore, nëse bombardimet kundër Serbisë nuk do të jepnin rezultat. Gjatë mandatit të tij si kryeministër e përkrahu ushtarakisht dhe politikisht SHBA-në në koalicionin kundër terrorizmit, që nga viti 2001. Më 2007 dha dorëheqje nga kryetari i Partisë Laburiste. Më pas kreu detyra të ndryshme, si emisar i paqes në Lindjen e Mesme, ndërsa pas vitit 2009 nisi projektin e tij të njohur rreth globalizimit. Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë, në Kosovës u emëruan me emrin e tij rrugë, sheshe etj., ndërsa në vitin 2009 Universiteti i Prishtinës i dha titullin Doctor Honoris Causa. (Naim Musliu)

BLETA. Bleta mjaltëse i përket tipit *Arthropoda*, klasës së insekteve, rendit *Himenoptera*, familjes *Apidea*, gjinisë *Apis Mellifera*. Ajo karakterizohet me disa cilësi që nuk i kanë llojet e



tjera të bletëve, siç është mundësia e saj për të jetuar vetëm në kuadër të familjes, e cila përbëhet nga dhjetëramijë bletë punëtore, disa qindra ose mijëra meshkuj dhe nga një mëmë e vetme. Kosova disponon

kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë, sepse ka klimë të përshtatshme dhe numër të madh të bimëve mjaltëdhënëse, nga të cilat bletët mbledhin nektarin dhe pjalmin. Flora e Kosovës është e pasur me drurë dhe shkurre që përmbajnë nektar ose pjaln në lulet e tyre. Disa nga këto bimë përbëjnë kullotat kryesore për bletën, siç janë pemët frutore (kumbulla, pjeshka, kajsia, qershia, dardha, molla), sherbela, tërfili dhe jonxha, gështenja, çaji i malit, luledielli dhe trumza. Në jetën e familjes së bletës gjatë vitit dallohet periudha e veprimtarisë aktive, kur familja mbledh dhe përpunon ushqimin, krijon rezervat e saj, rrit gjeneratën dhe shumëzohet dhe periudha e qetësisë

relative (vjeshtë e dimër), kur familja pushon së rrituri gjeneratën dhe jeton me rezervat ushqimore. Në ditët e sotme blea luan rol gjithnjë e më të madh në kryerjen e pjalmimit të kulturave bujqësore. Ndërkaq, edhe blea preket nga sëmundjet e ndryshme, nga të cilat duhen veçuar: pesta amerikane, pesta europiane; nozemoza; akarapidoza, varoatoza etj. Në Kosovë veprojnë rreth 6,500 bletarë me rreth 70,500 koshere. (Xhevat Domi)

BLYTA Aqif (1887-1945). Luftëtar i lëvizjes çlirimtare, organizator i mbrojtjes së Novi-Pazarit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Novi-Pazar, në një familje me origjinë nga Gjakova. Kreu Akademinë Ushtarake në Perandorinë Osmane dhe mori pjesë në Frontin e Lindjes në luftë kundër Rusisë. Më 1919 u kthye në vendlindje, ndihmoi Ferat Dragën për formimin e “Xhemietit” dhe u zgjodh sekretar i tij. Më 1920 u zgjodh kryetar i bashkisë së Pazarit të Ri, kurse më 1923 zgjidhet deputet në Parlamentin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Kundërshtoi politikën serbe për shpronësimin dhe shpërnguljen me dhunë të popullsisë shqiptare dhe boshnjake. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ngriti administratën shqiptare në Novi-Pazar dhe organizoi mbrojtjen e Sanxhakut nga çetnikët dhe partizanët serbë e malazezë. Ishte përkrahës i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe deputet në Kuvendin Kombëtar të Shqipërisë (1943-1944). Pas depërtimit të forcave partizane jugosllave dhe shqiptare në ato vise, iu dorëzua partizanëve në Gjakovë, të cilët e çuan në Novi-Pazar, ku u pushkatua nga OZN-a, bashkë me tre djemtë e tij. (Muhamet Shatri)

BLLACA Qazim (1915-2005). Veprimtar antikomunist, i burgosur politik. Lindi në Bllacë të Suharekës. Ishte i biri i Ramë Bllacës. Shkolën fillore dhe semimaturën i kreu në Prizren,



QAZIM BLLACA

ndërsa katër klasë të larta të gjimnazit i kreu në Kragujevc (Serbi). Studimet i vazhdoi në Beograd në fakultetin juridik. Më 1941 u kthye në vendlindje dhe u emërua nënprefekt në Suharekë dhe më pas prefekt i Prizrenit. Ishte deputet i Kuvendit Kombëtar të Shqipërisë gjatë viteve 1942-1943. Mbështeti dhe punoi në

organizimin e kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Gjatë vitit 1943 emërohet zëvendësministër për Ekonomi në Qeverinë e Rexhep Mitrovicës në Tiranë. Këtë detyrë e ushtroi deri në nëntor 1944, kur kthehet në Kosovë. Në dhjetor të vitit 1944 arrestohet nga OZN-a. Një kohë mbahet në burgun e Prizrenit dhe të Prishtinës, pastaj ekstradohet në Shqipëri dhe atje dënohet me 20 vjet burg. Në burgjet komuniste të Shqipërisë mbahet deri në vitin 1962, prej nga e dërgojnë në kampet e internimit, ku vuajti edhe 13 vite të tjera. Në qershor të vitit 1975 lirohet nga internimi dhe riatdhesohet në Kosovë. Vdiq dhe u varros në vendlindje me nderime ushtarake e shtetërore të Republikës së Kosovës. (Haki Kasumi)

BLLACA Ramë (1880-1937). Veprimtar për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Kosovë. Lindi në Bllacë të Suharekës. Që në rini mori pjesë në rezistencën kundër pushtimit



RAMË BLLACA


serb dhe bullgar në vitet 1913-1915. Pas Luftës së Parë Botërore u zgjodh kryetar komune në Duhël të Suharekës. Ishte pjesëtar aktiv i organizatës “Xhemijeti” (Bashkimi). Më 1921 u zgjodh deputet në Parlamentin e Mbretërisë Jugosllave për rrethin e Podgorit (Prizrenit), ndërsa në vitin 1929 u zgjodh deputet i Banovinës së Vardarit. Për shkak të aktivitetit kombëtar u arrestua tri herë me akuzë për vrasjen e oficerëve serbë. Edhe në vitin 1933 i fitoi zgjedhjet për kryetar të komunës, ndërsa më 1935 u zgjodh sërish deputet. Kundërshtoi hapur politikën serbe për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi dhe mbështeti veprimtarinë arsimore të Organizatës studentore shqiptare “Besa” të Zagrebit (1935) dhe të Organizatës së rinisë përparimtare të Kosovës “Drita” (1937). U vra në rrugë, derisa kthehej nga një mbledhje e Parlamentit të Mbretërisë Jugosllave. (Haki Kasumi)

BLLACA Rizah (1918-1988). Rapsod popullor nga Bllaca e Suharekës, interpretues dhe rikrijues i këngëve të shumta popullore. Ka ditur më shumë se 15 mijë vargje dhe i ka interpretuar më së shpeshti me përcjellje të sharkisë. Ishte interpretues i shkathët i këngës epike legjendare të ciklit të kreshnikëve, që

kishte krijuar mënyrën vetjake të interpretimit, me formula origjinale, me figuracion të veçantë, me përshkrime të hollësishme ambientale dhe me portretizimin origjinal të personazheve. Janë të njohura edhe interpretimet e tij të poezisë “Moj Shqypni e mjera Shqypni”, pastaj e disa këngëve nga “Lahuta e Malësisë” etj. Në shumë vise shqiptare ka kënduar këngë historike, disa nga të cilat i ka krijuar vetë. E quanin “Homeri shqiptar”. Incizimet e këngëve të tij ruhen në Arkivin e Institutit të Kulturës Popullore të Tiranës, ndërsa Instituti Albanologjik i Prishtinës i ka botuar vëllimet “Rizah Bllaca - Kangë popullore, I dhe II” (1997). (Sadri Fetiu)

BOBAJ Qazim (1952-1995). Klarinetist. Lindi në Prizren, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës, drejtimi instrumental për klarinet. Më pas i filloi studimet në Akademinë e Muzikës në Beograd, në drejtimin teorik dhe instrumental dhe i përfundoi në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Pas studimeve ishte mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, në Gjilan dhe Prishtinë, më pas redaktor i muzikës serioze në Radiotelevizionin e Prishtinës, kryetar i Shoqatës së Artistëve Muzikorë të Kosovës dhe kryetar i Lidhjes së Artistëve Muzikorë të ish-Jugosllavisë. Ishte klarinetist i dalluar dhe është prezentuar si solist, anëtar i trios a i Orkestrës Simfonike, në koncerte dhe manifestime muzikore: “Rinia Muzikore”, “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Skena Muzikore e Prishtinës”, “Tribuna e Opatisë”, “Lojërat Verore të Dubrovnikut”, Festivali Ndërkombëtar i Muzikës Bashkëkohore në Zagreb, “Pavijoni Artistik” në Beograd etj. Kishte repertor të gjerë me vepra teknikash bashkëkohore të kompozitorëve tanë dhe të huaj. Vdiq në një aksident trafiku. (Kristina Palokaj-Perkola)

BOBI Gani (1943-1995). Sociolog, gazetar, kritik letrar, profesor universiteti. Lindi në Lybeniq të Pejës, ku e mbaroi shkollën fillore, ndërsa të mesmen në Pejë. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar në të përditshmen “Rilindja” në periudhën 1968-1976. Ndërkohë ligjëroi sociologjinë e kulturës në katedrën filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik dhe në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. U doktorua në temën “Integrimi sociokulturor i shqiptarëve



GANI BOBI

ndërmjet dy luftërave botërore” (1985). Është autor i tri librave nga fusha e sociologjisë së kulturës: “Sprovimet e modernitetit” (1982), “Paradoksi kulturor” (1986), dhe “Konteksti i vetëkulturës” (1994), ndërsa pas vdekjes së tij Shtëpia botuese “Dukagjini” botoi kompletin e librave të tij në pesë vëllime (1997). G. Bobi shkroi për konceptin e vetëkulturës, intelektualin, diskursin, tërësinë funksionale të kulturës shqiptare, për akulturimin dhe për fenomene të tjera kulturore dhe politike të rëndësishme për kohën, sidomos për vitet ’90 të shekullit të kaluar. Në kompletin e veprave, në një vëllim të veçantë, janë botuar edhe disa dorëshkrime të pabotuara, me tema kryesisht nga sociologjia e kulturës. (Shemsi Krasniqi).

BOGA. Fshat në trevën e Rugovës, rreth 25 km në veriperëndim të qytetit të Pejës. Është vendbanim malor i tipit të shpërndarë, me lartësi mbidetare 1,655 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 992 ha, nga e cila shumica janë pyje dhe livadhe. Popullsia merret me blegtori dhe turizëm malor. Me këtë emër është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1896 dhe 1900. Një numër i konsiderueshëm i banorëve është shpërngulur në Pejë dhe qendrat e tjera të Kosovës, ndërsa disa familje kanë emigruar në Turqi. Sipas një raporti të konsullit austro-hungarez të Plevlës të vitit 1903 thuhet se fshati Bogë ka pasur 20 shtëpi. Në vitin 2011 kishte 24 banorë, ndaj 139 banorë në vitin 1921. Klima submalore, ajri i pastër, vegetacioni i dendur halor, kullosat dhe blegtoria tradicionale janë në kombinim harmonik mes vete, duke krijuar peizazhe unike dhe të rralla natyrore me vlera të shumta kulturore dhe etnografike. Këto veçori kanë filluar të valorizohen përmes zhvillimit të disa formave të turizmit. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 4-klasash dhe disa kapacitete receptive turistike. (Bajram Kafexholli)

BOGDANI Luka (shek. XVII). E njohim vetëm nga përkushtimi që është botuar në veprën e Pjetër Bogdanit “Çeta e profetëve” (1685): “Shumë ndriçimit e shumë ndersimit,

zotit, zotit tim, zot për ndër, zotit Pjetër Bogdan, argjupeshkëpit Skupsë, kusherinit tim dashunit”. (Rexhep Ismajli)

BOGDANI Ndre (1600-1683). Klerik i lartë, argjupeshkëv i Ohrit (1651-1656) dhe i Shkupit (1656-1677). I lindur në Gjonaj të Hasit, u shkollua në Kolegjin e Loretos (1631-1635), u kthye në Atdhe më 1936, ku qëndroi me shërbim një kohë (Gjonaj), për të vijuar pastaj në Janjevë dhe më tej në Argjupeshkvinë e Ohrit. Zhvilloi veprimtari fetare dhe arsimore, hartoi një gramatikë shqip të latinishtes, që kishte mbetur dorëshkrim dhe deri sot nuk është gjetur. Vdiq dhe u varros në Janjevë. (Rexhep Ismajli)

BOGDANI Pjetër (1627?-1689). Shkrimtar, mendimtar, klerik i lartë katolik, veprimtar i lëvizjes çlirimtare antiosmane. Lindi në Gur të Hasit të Prizrenit. Studioi në Kolegjin Urban të Kongregacionit të Propagandës së Fesë në Romë (1642-1647), vazhdoi në Kolegjin ilirik të Loretos (1647-1650), ku u doktorua në filozofi, ndërsa në teologji në Kolegjin Urban. Më 1655 u emëruar ipeshkëv i Sapës, në vitet



PJETËR BOGDANI

1656-1677 ipeshkëv i Shkodrës, nga 1659 administrator i dioqezës së Tivarit. Më 1671 hapi një shkollë për të rinj në Rrjoll. Në periudhën 1677-1689 ishte kryeipeshkëv i Shkupit dhe administrator i Serbisë. Më 1675 në Romë kërkoi t'i lejohej botimi i veprës “Skutat e profetëve mbi ardhjen e Mesisë”. Përgjigja që e prerë: të përkthehej italisht dhe t'i jepej për korrigjim De Albitiis. Në Vatikan ka shkruar për idenë e organizimit të një kryengritjeje të përgjithshme në Shqipëri. Ka qëndruar në Padovë të G. Barbarigo (1622-1697), i cili e ka ndihmuar materialisht për botimin e veprës më 1685. Më 1689 bashkë me austriakët ndodhej në frontin antiosman. Ka organizuar 5,000 ushtarë. Ka shkruar në Prizren me gjeneralin Piccolomini, i cili ka vdekur atje nga murtaja. I kthyer në Prishtinë Bogdani ka vdekur nga po ajo sëmundje. Në Padova Bogdani është marrë me veprën e tij, që donte të botohej shqip dhe italisht: “Çeta e profetëve e Krishtit shpëtimtar të botës dhe e vërteta e saj evangjelike”, Pjesa e

parë, (“Cvnevs prophetarum de Christo salvatore mvndi et eius evangelica veritate”). Pjesa e dytë: “Mbi jetën e Jezu Krishtit shpëtimtarit të botës dhe të vërtetën e tij evangjelike” (“De vita Iesv Christi salvatoris mvndi et eius evangelica veritate”), të dyja në Padovë 1685. Vepra ka pasur ribotime më 1691 e 1702 në Itali dhe një botim të ri anastatik nga Z. Valentini e M. Camaj në Munih më 1977. Botime të pjesërishme kanë bërë N. Mjedja më 1930, M. Harapi në vitet 1940-43, G. Weigand e M. Sciambra. Botim të plotë ka bërë Engjëll Sedaj: “Pjetër Bogdani. Çeta e profetëve” I, fototipi me përshtatje në gjuhën e sotme e përkthime, Rilindja, Prishtinë 1989 dhe II, Drita, Prizren 1997. Një transkriptim diplomatik virtual të veprës e ka bërë Michiel de Vaan: “Bogdani: Cuneus Prophetarum. Part. I: Vetus testamentum. Part II: Novum Testamentum”, data entered 2003. Anila Omari ka bërë botimin kritik me fototipi, transkriptim dhe komente: “Pjetër Bogdani. Cuneus prophetarum. Botim kritik”, Tiranë 2005. Për Bogdanin janë botuar studime të ndryshme. Po përmendim: L. Marlekaj: “Pjetër Bogdani dhe Shqipëria e kohës së tij” (Pietro Bogdani e l’Albania del suo tempo, Bari 1989); O. Marquet: “Pjetër Bogdani, Letra dhe dokumente” (Shkodër 1997); M. Sciambra: “Bogdanica II”, Bologna 1964); S. Riza: “Pesë autorët më të vjetër” (Tiranë 1966, botuar së pari më 2002), I. Rugova: “Vepra e Bogdanit” (Prishtinë, 1982); Sh. Osmani: “Pjetër Bogdani” (Tiranë, 1996). Vepra e Bogdanit i kapërcen kufijtë e tekstit doktrinar fetar. Gjuha e Bogdanit paraqet kulmin e lëvrimit të shqipes letrare ndër autorët e vjetër, jep shembullin e proceseve koineizuese. Përveç interpretimeve doktrinare, në të kemi shpjegime filozofike për krijimin e botës, interpretime, koncepte teologjike e filozofike, rrëfime dhe poezi. Vetëdija e tij prej shkrimtari manifestohej në frazën e gjatë racionale, me leksik të zgjedhur, me terma të shumtë, me përpjekje për të bërë diferencim të stileve, në prozë; me varg të punuar, me metër të ndryshuar jo thejsht popullore në poezi. Në rrafshin e ngritjes së një norme drejtshkrimore te Bogdani mund të hetohen parime që do ta shpinin përpara shkrimin e shqipes në raport me Budin: shënimi i hundorësisë, shënimi i ë-së si e me theks të rëndë, ndarja më konsekuente e klitikëve, etj. Është çmuar si shkrimtari më i rëndësishëm i letërsisë së vjetër shqipe.

Një pjesë e studiuesve mendon se Bogdani ka dashur të vendosë një metodë apologetike ‘moderne’ duke bërë një vepër pozitive për “të vërtetën e besimit të Krishterë”. Të tjerë e shohin si vështrim të gjerë që, duke u lidhur me fatet e vendit, lidhej edhe me humanizmin. Të tjerë kanë theksuar se kjo vepër përmban trajtime me interes për filozofi, teologji, shkencë, ndërsa në poezitë dhe prozat letrare të përfshira në vepër shihen prejke të çështjeve të estetikës. Studiuesit e vonë veprën dhe veprimtarinë e Bogdanit i kanë parë me rëndësi për zhvillimet kulturore-historike dhe për letërsinë shqiptare. I. Rugova veprën “Çeta e profetëve” e vlerësonte si vepër bazë të humanistikës shqiptare. (Rexhep Ismajli)

BOGDANI Ramazan (1934-). Etnokoreolog, studiues i folklorit. Lindi në Tiranë. Mbaroi Institutin Pedagogjik më 1963, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës më 1969. Një kohë punoi si valltar solist dhe koreograf në Filarmoninë Shqiptare dhe në Teatrin e Operës dhe të Baletit. Në vitet 1967-2004 ishte punonjës shkencor në Institutin e Kulturës Popullore (Tiranë). Është autor i shumë studimeve etnokoreografike: “Të njohim vallet tona” (1976), “Folklori koreografik i Hasit” (1977), “Në truallin e vallës popullore” (1978), “Gjurmime koreografike” (1995), “Vallet e Lunxherisë” (1995), “Vallëzimi popullor shqiptar” (1997), “Visare etnografike” (2003), “Etnokoreografi kosovare hasjane” (2005), “Etnokoreografia” (në pesë vëllime) (1965-2004), “Diaspora etnokoreografike” (2013) etj. Ka marrë pjesë në ekspedita kërkimore-shkencore në Rugovë, në Opojë e në Has dhe në shumë vise të Maqedonisë. Ka marrë pjesë gjithashtu në një sërë kongresesh dhe simpoziumesh me kumtesa për folklorin koreografik shqiptar. Nga viti 2010 mban titullin “Mjeshtër i Madh”. Jeton dhe vepron në Tiranë. (Krenar Doli)

BOGUJEVCI Mehmet (1951-). Boksier. Lindi në fshatin Bresje të Fushë Kosovës. Filloi të merrte me boks në vitin 1965 në KB “Spartaku” të Suboticës (Vojvodinë). Pas pesë vjetësh (1969) bëhet anëtar i KB “Radnički” të Prishtinës, që pas pak kohësh mori emrin “Prishtina”. Gjatë karrierës së tij fitoi shumë tituj, ndërsa sukseset më të mëdha janë: dy herë kampion i ish-Jugosllavisë për të rinj, katër herë nënkampion

i ish-Jugosllavisë në konkurrencën vetjake, pesë herë kampion me KB “Prishtina”, fitues i medaljes së bronzit në Kampionatin Europian (Halle, Gjermani, 1977), nënkampion botëror (1978, Beograd), fitues i medaljes së artë në Lojërat e Mesdheut (1979, Split, Kroaci), i pesti në Lojërat Olimpikë (1980, Moskë). Është sekretar i përgjithshëm i Federatës së Boksit të Kosovës dhe nënkryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës. (Bekim Aliu)

BOGUMILËT. Përfaqësues të lëvizjes fetare heretike, themeluar nga kleriku Bogumil (“I dashuri i Zotit”) në shek. X. Bogumilët së pari u shfaqën në Bullgari dhe Maqedoni, në kohën e perandorit bullgar, Pjetrit (969). Më vonë u përhapën edhe në Arbëri, Dalmaci, Rashë, Bosnjë, Itali etj. Në burimet greke njiheshin me emrin *fundagiagita*, ndërkaq te sllavët e Ballkanit si *babuni* ose *torbeshi*. Bogumilët theksonin nevojën e kthimit të krishterimi burimor, duke luftuar hierarkinë kishtare dhe atë feudale. Baza shoqërore e kësaj lëvizjeje ishte heterogjene. Kleriku Kozma i akuzonte se propagandonin mosdëgjueshmëri ndaj feudalëve dhe perandorit. Më vonë në Bosnjë identifikohen me fisnikërinë vendore, e cila luftonte hungarezët si bartës të katolicizmit. Në hapësirat arbërore herezia bogumile përmendet në fillim të shek. X, kur Kozmai dëshmon për dyndjet e tyre përtej detit, përkatësisht drejt Italisë, ku i ndeshim në shek. XII në Bergamo dhe Verona me emër “Albanesi” dhe kishën e tyre “Ecclesia albanese” (kisha arbërore). Më vonë bogumilizmin në hapësirat arbërore e hasim të dokumentuar edhe gjatë shek. XIII dhe gjysmës së parë të shek. XIV, kur në dy letrat papale përmendet shtrirja e tyre nga Durrësi deri në Raguzë. Bogumilët ishin të përndjekur edhe nga feudalët arbërorë. Janë të njohur edhe me sinonime të tjera, si babunë në Rashë, Maqedoni e Kosovë, paterenë në Bosnjë e Hercegovinë, katarë në Itali dhe albizhanë në Francë. (Muhamet Mala)

BOJA Feriz (1910-1977). Luftëtar për çlirimin e Kosovës, veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Kërrnicë të Klinës. Më 1944 iu bashkua Shaban Palluzhës si njëri ndër njerëzit më të besueshëm të tij. Më 6 janar 1945 në Mitrovicë ishte në bisedime me Fadil Hoxhën, bashkë me Shaban Polluzhën. Në mbledhjen e datës

23 janar 1945 për merita në organizim dhe në strategji ushtarake u gradua major. Pas vrasjes së Shaban Palluzhës, e vazhdoi aktivitetin në kuadër të LNDSH-së. Kuvendi i Dobërdolit e emëroi udhëheqës ushtarak të rrethit të Istogut. Ishte nënshkrues i raportit që Ymer Berisha i dërgoi gjeneralit anglez Hadson. Pas kuvendit të Dobërdolit kaloi në çetën e Ndue Përlleshit. Gjyqi ushtarak e dënoi me pushkatim, pastaj me burg të përjetshëm dhe së fundi me 25 vjet burg. I kaloi 13 vjet në burgjet e Nishit dhe Mitrovicës së Sremit. Nga burgu u lirua më 1961. Vdiq në fshatin e lindjes. (Lush Culaj).

BOJA Myfti Rexhep (1946-). Titullar i fesë islame, ambasador. Lindi në fshatin Kërnice të Klinës. Shkollën tetëvjeçare e kreu në Pejë, të mesmen në Medinë të Arabisë Saudite, studimet në Universitetin Islamik.



REXHEP BOJA

Po në Medinë kreu edhe studimet pas-universitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës. Më 1986 u kthye në Kosovë dhe u caktua imam në Xhaminë e Kapishnicës në Pejë. Në të njëjtën kohë u angazhua si mësimdhënës në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë. Në vitin 1991 u zgjodh kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), funksion që e ushtroi deri në vitin 2003. Ishte njëri ndër bartësit e projektit për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë (1992) dhe dekan e pedagog në këtë fakultet. Mori pjesë në shumë aktivitete ndërkombëtare dhe e përfaqësoi Kosovën në shumë takime të rëndësishme. Më 2012 u emërua ambasador i Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite. Është autor i disa veprave të botuara në gjuhën arabe: “Shqiptarët në islam” dhe “Myslimanët në ish-Jugosllavi”, botuar në Kajro më 2004 dhe në gjuhën shqipe “Për një të nesërme më të mirë” (2003) etj. (Qemajl Morina)

BOJANIQ Dushanka (Dušanka Bojanić) (1927-2004). Orientaliste-osmanologe e Universitetit të Beogradit. I takonte gjeneratës së parë të orientalistëve pas Luftës së Dytë Botërore në katedrën për orientalistikë të Universitetit të Beogradit. Deri në pensionim punoi si mësimdhënëse në katedrën e orientalistikës të Fakultetit të Filologjisë në

Beograd. Si rezultat i hulumtimeve sistematike të dokumentacionit të papublikuar arkivor të arkivave ballkanike, sidomos të Arkivit Shtetëror të Turqisë në Stamboll, botoi një numër të madh veprash dhe artikujsh shkencorë nga fusha e historisë së popujve të Ballkanit gjatë sundimit osman. Punimet e saj shkencore u publikuan në disa gjuhë ballkanike dhe botërore. Publikoi po ashtu një sërë dokumentesh osmane nga arkivat e Stambollit, sidomos mbi Maqedoninë dhe Serbinë. Veprat e saj i shquan objektiviteti shkencor edhe sa i përket historisë shqiptare gjatë shekujve të parë të sundimit osman. (Gazmend Rizaj)

BOJKU Fejzi (1937-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Veleshtë të Strugës. Mësimet e para i kreu në vendlindje dhe në Strugë. Shkollën normale dhe të lartën pedagogjike, dega e frëngjishtes, i kreu në Shkup, kurse studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Shkup. Kreu dhe studimet në Institutin e Gazetarisë në Beograd. Punoi si mësues në vendlindje. Në vitet 1960-1991 qe gazetar në



FEJZI BOJKU

“Flaka e vëllazërimit”. Në vitet 1964-1991 ishte dhe redaktor përgjegjës i revistave “Gëzimi” e “Fatosi”, kurse dy vjet kryeredaktor i botimeve shqipe në Ndërmarrjen Botuese “Flaka e vëllazërimit”. Botoi vepra poetike dhe tregime për fëmijë: “Lulet e para” (1969), “Zilet shkollore” (1971), “Këngët e shkronjave” (1972, me Ali Huruglicën), “Shtatori i një fëmijërie” (1973), “Hyri vallja në shtëpi” (1977), “Ngjyrat e qiellit tim” (1977), “Flutura të bardha” (1980), “Fjalë e valë” (1987), si dhe “Tungjatjeta vjeshtë” (2002), “Çfarë i falëm ditës” (2002), “Sa është ora” (2002) dhe “Tregimet e babait” (2006). Përkthyeu nga maqedonishtja dhe serbokroatishtja në shqip, ku veçohen: “Mirë për të gjithë” (tregime të autorëve botërorë) dhe “Ti e ke zemrën time” (270 poezi të mbi 250 autorëve botërorë). (Fatmir Sulejmani)

BOKSI. Fillet e boksit në Kosovë paraqiten në vitin 1920. Më 1932 u themelua seksioni i parë i boksit, me nismën e një hungarezi që asokohe punonte në Prishtinë. Pas Luftës së Dytë Botërore boksi paraqitet fillimisht në Prishtinë

(1948). Në vitin 1949 formohet Këshilli i Boksit të Kosovës. Prej vitit 1951 e deri më 1959 Kosova përfaqësohej vetëm me një klub “Milicionarin” e Prishtinës, që bënte gara në nënlidhjen e rajonit të Nishit, kur edhe ndërroi emrin në “Radnički”. Po ky klub më vonë mori emrin “Prishtina”, kur u shfaq në skenë trajneri më i mirë shqiptar, Lah Nimani, i cili pesë herë fitoi titullin e kampionit të ish-Jugosllavisë dhe gjashtë herë ishte nënkampion. Nimani, njëkohësisht ishte edhe trajner i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë dhe me boksierët, si Aziz Salihu (fitues i medaljes së bronzit në lojërat olimpike në Los-Anxhelos, më 1984), Mehmet Bogujevci (nënkampion bote në Beograd, më 1978), Sami Buzolli (medalja e bronzit në botërorin e Munihut, më 1982), Nazif Gashi, Xhevdet Peci, Afrim Majanci etj., morën pjesë në garat më të mëdha ndërkombëtare, që nga Lojërat Olimpikë, kampionatet europiane e botërore, e deri të ato ballkanike dhe në Lojërat e Mesdheut. Si rezultat i punës profesionale, shkëlqimin e tyre në Europë dhe në SHBA e vazhduan Luan Krasniqi, Haxhi Krasniqi dhe Nuri Seferi në Gjermani, Elvir Muriqi në SHBA etj., tashmë si profesionistë. Kosova ka pasur dhe vazhdon të ketë shumë klube cilësore të boksit, si: “Prishtina”, “Trepça” (Mitrovicë), “Drita” (Gjilan), “Peja”, “Kastrioti” (Ferizaj), “Gjakova”, “Prizreni” etj. Federata e Boksit e Kosovës u pranua me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Boksit (AIBA). Ky vendim u mor në kongresin e AIBA-s i mbajtur në Jeju të Koresë së Jugut (nëntor 2014). Kosova mori votat e njëzëshme. (Xhavit Kajtazi)

BOKSHI Besim (1930-2014). Gjuhëtar, profesor universitar, akademik, poet. Lindi në Gjakovë. Mësimet e fillores i ka përfunduar në Tiranë dhe në Gjakovë, maturën në gjimnazin e Prishtinës. Është diplomuar në katedrën e albanologjisë në Beograd, ku i ka vijuar studimet pasuniversitare në drejtimin e gjuhësisë. Në Fakultetin Filozofik në Prishtinë ka mbrojtur temën e disertacionit të doktoratës



BESIM BOKSHI

rreth formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes (1977). Ishte mësimdhënës dhe drejtor i gjimnazit të Gjakovës si dhe i Shko-

llës së Lartë Pedagogjike të Gjakovës. Nga viti 1974 në Universitetin e Prishtinës ka ligjëruar lëndët morfologji historike dhe hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane. Ishte anëtar i komisionit për konkluzione të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës më 1968 dhe delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë më 1972. Ka qenë deputet në Dhomën për Arsim në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë (1967-1969). Në vitet 1993-1996 ka qenë kryetar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) është zgjedhur më 1991, ndërsa nga viti 1996 është zgjedhur anëtar i rregullt i saj. Në periudhën 2002-2005 ishte nënkryetar dhe më pas, në vitet 2008-2011, ishte kryetar i ASHAK-ut. Ka qenë anëtar i kryesisë së Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Hyn në radhën e poetëve të parë modernë të Kosovës. Ka publikuar vëllimin me poezi “Në pritje” më 1966 dhe një numër poezish të tjera më pas në kohë të ndryshme në shtypin e kohës. Më 1996 botoi përmbledhjen me aforizma “Hije të këputura”. Shquhet si poet i refleksionit dhe i fjalës së kursyer e me nëntekste për qeniesinë, për aktualitetin social, nga fundi dhe për aspekte politike. Kontributin kryesor e ka dhënë në studimet e strukturës së hershme të shqipes dhe të zhvillimit të fleksionit nominal të saj. Monografia e tij për këto çështje u botua më 1980. Botoi edhe monografitë “Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike” (1984), “Pjesorja e shqipes” (1998), “Për vetorët e shqipes” (2003) dhe “Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes” (2010). Pas vdekjes është botuar edhe libri i tij “Varia”, një përmbledhje studimesh të mëhershme dhe të reja. Në këto studime ai ka paraqitur vizionin e tij për zhvillimet e sistemit nominal të shqipes qysh nga fazat më të hershme, duke u ngjitur nëpër periudhat e dokumentuara e deri në kohët e reja. Studimet e tij dallohen për këndvështrimin struktural e glosematist dhe përpjekjet për të sqaruar strukturat e shqipes në diakroni. E shquan origjinaliteti dhe thellësia e mendimit. Konsiderohet ndër gjuhëtarët më novatorë shqiptarë. (Bardh Rugova)

BOKSHI Ilir (1966-) Regjisor. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për regji teatri në Fakultetin për Film dhe Teatër të Universitetit të



ILIR BOKSHI

Bukureshtit në Rumani (1993). Është regjisor i një sërë shfaqjesh, fillimisht të realizuara në Teatrin Popullor të Gjakovës, si “Antigona”, “Provo edhe njëherë Sem” etj. Në Teatrin Popullor Krahinor inskenoi shfaqjen “Historia e atyre që s’janë” (1994), kurse në po këtë teatër, përkatësisht në Teatrin Kombëtar të Kosovës në periudhën e pasluftës (1999) ka bërë regjinë e një sërë shfaqjesh, si “Fluturimi mbi folenë e qyqes” (2000), “Ëndrra e një nate vere” (2002), “Rikardi III” (2004), “Nata e dymbëdhjetë” (2011) dhe “Ferma e kafshëve” (2015). Në këtë kuadër duan përmendur edhe shfaqjet: “Menaxheria e qelqtë” (2002) në Teatrin “Dodona”, “Monologët e vagjinës” (2003) në Teatrin “Oda” etj. Bashkëpunoi edhe me qendrat teatrore jashtë Prishtinës dhe Kosovës, veçmas në periudhën pas luftës, ku realizoi një numër shfaqjesh pothuajse në të gjitha teatrot profesionale të Kosovës. Me Teatrin e Qytetit të Gjakovës ka realizuar shfaqjet “Hiqe ministrin nga priza” (2007) dhe “Mbretëresha e bukur e Llenanit”; pastaj në Teatrin e Prizrenit ka realizuar shfaqjet “Togeri nga Inishmori” (2008); ndërsa me Teatrin e Qytetit të Gjilanit ka vënë në skenë shfaqjet “Sakati nga Inishmani” (2010) dhe “Mon Liku” (2012). Ndërkaq në Teatrin e Qytetit të Mitrovicës ka inskenuar shfaqjen “Vetmi në Perëndim” (2011). Në vitin 2013, në inskenim të Teatrit të Operas dhe të Baletit në Tiranë ka realizuar regjinë e shfaqjes “Edipi mbret”, që është vlerësuar si një nga shfaqjet e tij më të realizuara. Ndërkaq në vitin 2014 në Tetarin e Korçës ka vënë në skenë dramën “Një kafkë nga Konemara”. Në kuadër të bashkëpunimit të tij me qendrat dhe shtëpitë teatrore jashtë Kosovës, do veçuar edhe bashkëpunimi me Teatrin Shqiptar të Shkupit, ku ka vënë në skenë shfaqjet “Kafeneja në udhëkryq” (2003) dhe “Paraja” (2012), si dhe me Teatrin e Tetovës, ku ka vënë në skenë dramën “Çifti i çuditshëm” (2013) dhe “Kuzhinat” (2015). Në vitin 2016, me Teatrin e Gjakovës e ka bërë edhe regjinë e dramës “Dorëzimi në Spokan”. (Besim Rexhaj)

BOLETINI Adem (1895-1943). Luftëtar i lëvizjes çlirimtare, oficer karriere, djali i tretë i Isa

Boletinit. Që në moshën 16-vjeçare e shoqëroi të atin në udhëtimin historik për në Vlorë. Në Vjenë filloi studimet në akademinë ushtarake, të cilat i përfundoi në Modena të Italisë. Në Shqipëri shërbeu si ushtarak karriere. Ishte komandant dhe pedagog i Shkollës Ushtarake të Oficerëve në Tiranë dhe Durrës. Në prill të vitit 1941, pas kapitullimi të Jugosllavisë, u kthye në Kosovë. U angazhua në koordinimin e luftimeve të vullnetarëve të udhëhequr nga prijësit e Shalës së Bajgorës, kundër sulmeve të forcave serbe në kufirin verior. U vra në vitin 1943, në një atentat të përgatitur nga guerilët partizanë në Shkodër. Në vitin 1946 pushteti komunist i Shqipërisë burgosi edhe bashkëshorten e tij, duke mos kursyer më pas as dy djemtë e tij. Pas demokratizimit të vendit, u dekorua nga presidenti i Shqipërisë me Urdhrin “Për Veprimtari Patriotike” të Klasit të Parë. (Muhamet Shatri)

BOLETINI Isa (1864-1916). Prijës popullor i luftërave çlirimtare për mëvetësimin e Shqipërisë dhe çlirimin e Kosovës, Hero i Popullit. Lindi në fshatin Boletin të Shalës së Bajgorës.



ISA BOLETINI

Rridhte nga një familje e njohur në Mitrovicë dhe në vilajetin e Kosovës. Si 17-vjeçar mori pjesë në betejën e Slivovës të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por u bë i njohur si prijës popullor në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, kur u intensifikuan luftërat kundër pushtetit osman dhe u ashpërsuan kërcënimet e shteteve fqinje ndaj territoreve shqiptare. Ishte përkrahës i Haxhi Zekës dhe i Lidhjes së Pejës. Në fillim të shekullit XX u vu në krye të rezistencës popullore kundër ndërhyrjeve të Serbisë dhe Malit të Zi në territoret shqiptare. Më 1908 përkrahu revolucionin xhonturk dhe ishte njëri nga organizatorët e Kuvendit të Ferizajt, që pati rëndësi në miratimin e kushtetutës. Por më pas u ngrit kundër politikës antishqiptare të xhonturqve. Më 22 nëntor të vitit 1908 forcat ushtarake të Perandorisë Osmane rrethuan dhe më pas dogjën kullën e I. Boletinit në fshatin Boletin. Duke e parë rrezikun nga ushtria osmane, së bashku me familjen vendoset në Isniq, ku më vonë forcat ushtarake osmane, nën komandën e Xhavit Pashës, rrethuan Isniqin,

Strellcin e Epërm dhe atë të Poshtëm, me synim që ta arrestonin. Duke mos arritur ta kapnin, rrethimi i Isniqit u përsërit edhe më 25 mars 1909, por pa sukses. Në fillim të vitit 1910 bisedoi në Isniq me parinë e Rekës e të Malësisë së Gjakovës. Pas një qëndrimi të shkurtër në Mal të Zi, kthehet sërish në krye të kryengritësve në betejat me forcat osmane në Shtime-Carrallevë në vitin 1910 dhe më 2011 udhëhoqi kryengritësit në zonat e Mitrovicës, Podujevës dhe Prishtinës, duke çliruar një pas një qytetet e Kosovës, përfshirë edhe Shkupin. Më pas u vu në krye të vullnetarëve për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga sulmet e pushtuesve serbë. Në ditët e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë u gjend në krah të Ismail Qemalit dhe ishte pjesëmarrës aktiv në organizimin e mbrojtjes së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Më 1913, së bashku me Ismail Qemalin, shkoi në Londër në përbërje të delegacionit të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve. Më pas u kthye në Kosovë, ku sërish organizoi forcat vullnetare kundër pushtimit serbo-malazez, por gjendja e tij shëndetësore filloi të rëndohej dita-ditës. Në këto rrethana shkoi në Shkodër dhe, në përpjekje për t'u larguar që andej, kërkon ndihmë në konsullatën franceze, e cila ia dorëzoi Malit të Zi. Pas qëndrimit disa javësh në Nikshiq, u kthye në Podgoricë dhe aty, pak orë para pushtimit të këtij qyteti nga ushtria austro-hungareze, u organizua atentati për vrasjen e tij nga komandanti lokal Sava Llazareviq. Në luftimet me forcat ushtarake dhe policore malazeze më 23 janar 1916 u vra I. Boletini me dy djemtë, dy nipat dhe tre bashkëluftëtarë të tij. (Isa Bicaj)

BOLETINI Tafil (1888-1970). Lindi në Boletin, afër Mitrovicës. Në moshën 6-vjeçare ia vranë babanë, Ahmetin, dhe nga kjo kohë për të u përkujdes xhaxhai i tij, Isa Boletini. Mësimet e para i mori nga



TAFIL BOLETINI

mësuesi Imer Efendiu, ndërsa pas vendosjes së Isa Boletinit në Stamboll, vazhdoi studimet ushtarake. Pas revolucionit xhonturk, bashkë me xhaxhanë e tij kthehet në Kosovë. Mori pjesë bashkë me Isën në të gjitha takimet më udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare. Bashkë me të shkoi në Vlorë dhe

udhëhoqën njësitë vullnetare. Në kryengritjen e shtatorit të vitit 1913, T. Boletini ishte pjesëmarrës aktiv në luftime. Ishte përkrahës i Princ Vidit. Ishte dëshmitar i vrasjes së Isa Boletinit dhe më pas u kthye në Boletin dhe u përkujdes për familjen. Ishte anëtar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. I rrezikuar nga organet serbe, në nëntor të vitit 1920 shkoi në Shkodër. Nga kjo kohë e deri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia kreu detyra më rëndësi në shumë qytete të Shqipërisë. Në nëntor të vitit 1941 u kthye në Kosovë dhe ushtroi detyrën e prefektit në Pejës dhe dha kontribut për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore jetoi në Kosovë, por nën trysinë e madhe të organeve shtetërore jugosllave. Iu bë trysni edhe me burgosjen e djalit të tij, Aliut. Në këto rrethana, T. Boletini bënte kërkesë që të kthehet në Shqipëri. Më 6 tetor 1963, i përcjellë nga shumë shokë, miq e familjarë largohet nga Kosova dhe vendoset në Shqipëri. T. Boletini la në dorëshkrim dy vëllime me kujtime me titull “Pranë Isa Boletinit”. Vdiq në Tiranë. (Isa Bicaj)

BOLETINI. Fshat në komunën e Mitrovicës, rreth 5 km në veri të qendrës komunale. Është vendbanim i tipit të shpërndarë. Është vendlindja e heroit kombëtar Isa Boletini. Toponimet, gërmadhat dhe gjetjet e tjera të kulturës materiale dëshmojnë për vjetërsinë e vendbanimit. Nga presioni dhe dhuna e vazhdueshme e serbëve, disa familje në vitin 1928 shpërngulen në Shqipëri, ndërsa në këtë vendbanim sillen kolonë serbë. Deri në vitin 1999 kishte rreth 35 shtëpi me 350 banorë shqiptarë. Boletini është përfshirë nga valët intensive të shpërnguljes edhe në ditët e sotme. (Skender Halimi)

BONE Gijom (Guillaume Bonnet) (1965-). Gjuhëtar frëng. Studioi në École Normale Supérieure (ENS). Ka qenë profesor i gjuhësisë në Universitetin e Burgundit, Dizhon, Francë. Është specialist i gramatikës së latinishtes klasike dhe të mesjetës si dhe i shqipes dhe i historisë së saj. Ka marrë pjesë edhe në projekte të përkthimit. Shkroi për ndikimet e latinishtes në shqipen: “Fjalët latine të shqipes, fonetikë dhe morfologji” (Les Mots latins de l'albanais, 1998). Në këtë vepër leksiku i shqipes i huazuar nga latinishtja i është nënshtruar një hulumtim të plotë fonetik dhe morfologjik, me

ç'rast është shpjeguar edhe sistemi fonologjik i protoshqipes në kohën e kontakteve me latinishten. (Imri Badallaj)

BOP Franc (BOPP Franz) (1791-1867). Gjuhëtar gjerman, albanolog, indoeuropianist. Ishte profesor i Universitetit të Berlinit. Në rrafshin e gjuhësisë krahasuese indoeuropiane studioi edhe gjuhën



FRANC BOP

shqipe. Ndhimesë nis-mëtare ka dhënë për vështrimin në rrafshin krahasues të strukturës gramatikore të shqipes. Më 1843 e kishte formuluar idenë se shqipja i përket familjes gjuhësore indoeuropiane. Bopi hyri në historinë e shkencave albanologjike si studiuesi që argumentoi karakterin indoeuropian të shqipes. Në monografinë “Mbi gjuhën shqipe në lidhjet e farefisnisë gjuhësore të saj” (Berlin, 1854), analizoi strukturën morfologjike të shqipes dhe konstatoi se ajo i ka elementet e rëndësishme indoeuropiane, por nuk ka lidhje të ngushtë me asnjërën nga to. (Mensur Vokri)

BORECKI Norbert (Norbert Boretzky) (1935-). Gjuhëtar gjerman. Studimet për sllavistikë dhe gjuhësi krahasimtare i mbaroi në Universitetin e Bonit. Profesor për gjuhësi krahasimtare në Bohum. Fushat kryesore të studimit të tij janë: gjuhësia historike, kontaktet e gjuhëve, sllavistika, kreolistika, ballkanistika, albanistika. Botoi në dy vëllime librin për ndikimin e gjuhës turke në shqipen: “Ndikimi i turqishtes në shqipen. 1. Fonologjia dhe morfologjia e turqizmeve në gjuhën shqipe” (Der türkische Einfluß auf das Albanische. 1. Phonologie u. Morphologie der albanischen Turzismen”, 1975) dhe “Ndikimi i turqishtes në shqipen. 2. Fjalori i turqizmeve në gjuhën shqipe” (“Der türkische Einfluß auf das Albanische 2. Wörterbuch der albanischen Turzismen”) (1976). Botoi edhe shumë studime të tjera për shqipen dhe për shqipen në kuadër të ballkanistikës. Merret me studimin e romishtes së Kosovës. Është autoritetin kryesor në studimet romologjike. (Milote Sadiku)

BORXHA Nilo (Borgia Nilo) (1870-1942). Bibliofil, filolog, shkrimtar, studiues dhe teolog arbëresh. Ka lënë një varg shkrimesh që

lidhen me kulturën dhe religjionin bizantin, si dhe një studim për “Perikopenë e Ungjillit” të zbuluar në Grotaferratë të Italisë. Borxha lindi në Horën arbëreshe në Sicili; shërbeu në abacinë e Grotaferratës si bibliotekar dhe inspektor i bibliotekës. Ka bërë një studim për “Perikopenë e Ungjillit të Pashkëve” (“Pericope Evangelica in lingua albanese del sec. XIV da un manoscritto greco della Biblioteca Ambrosiana”), tekst kishtar me grafema greke dhe fjalë shqipe, që konsiderohet ndër tekstet më të hershme të dokumentuara shqipe (1930). E ka transkriptuar dhe komentuar këtë tekst të shekullit XV. Botoi dy vëllime për murgjit bazilianë në Shqipëri. (Imri Badallaj)

BORXHI I JASHTËM. U referohet detyrimeve të borxhit të një shteti, të një sektori ose njësie ndaj jorezidentëve, të cilët kërkojnë pagesën e interesit ose të kryegjësë nga debitori në një periudhë të ardhshme kohore. Borxhi i jashtëm përfshin borxhin ndaj bankave private komerciale, ndaj qeverive të tjera, ose të institucioneve financiare ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Borxhi i jashtëm i Kosovës në vitin 2014, duke përfshirë edhe obligimet para vitit 1999, ishte rreth 30% të prodhimit të brendshëm bruto. Borxhi i jashtëm i Kosovës kryesisht përbehet nga borxhi i sektorit privat, që përfaqëson rreth 77% të krejt borxhit të jashtëm, ndërsa pjesa e mbetur përfaqësohet nga borxhi që sektori publik ka ndaj sektorit të jashtëm. (Arben Mustafa)

BORXHI PUBLIK (SHTETËROR). I njohur edhe si huaja publike, borxhi nacional ose borxhi shtetëror është tërësia e borxhit që një qeveri ka ndaj një pale të tretë. Borxhi publik mund të jetë i brendshëm, nëse është gjeneruar nga borxhdhënësit e brendshëm, apo i jashtëm, nëse është gjeneruar nga kreditorët e huaj. Një formë tjetër e ndarjes së borxhit publik është sipas kohëzgjatjes së tij. Nëse borxhi i marrë është për një periudhë më të vogël se përafësisht periudha njëvjeçare, atëherë bëhet fjalë për një periudhë afatshkurtër. Nëse borxhi është marrë për një periudhë më të gjatë, mbi dhjetëvjeçare, atëherë bëhet fjalë për një periudhë afatgjatë. Borxhi afatmesëm bën pjesë në mes të këtyre dy kufijve. Borxhi publik është një formë e zakonshme e financimit të aktiviteteve shtetërore dhe gjenerohet nëpërmjet kredimarrjes apo të letrave me vlerë.

Vendet anëtare të Bashkimit European e kanë të specifikuar tolerancën për nivelin e borxhit publik nëpërmjet vetë traktatit të themelimit të Komunitetit European, ku specifikohet se borxhi publik i një qeverie përkatëse nuk duhet të kalojë 60% të brutoproduktit vendor të atij vendi. Në Kosovë, në vitin 2015 borxhi publik si proporcion i brutoproduktit vendor është rreth 20%, me një trend të rritjes mesatare prej 2% për secilin vit. (Lumir Abdixhiku)

BOSHKOVIQ (Bošković) Branko (1930-). Historian, profesor universiteti. Lindi në fshatin Krushec të Pejës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, ndërkaq shkollën e lartë për mësues në Banja Llukë (Bosnjë e Hercegovinë). Më 1960 i përfundoi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Doktoroi në vitin 1967 në Universitetin e Beogradit, kurse më 1967 u zgjodh docent në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Në vitin 1974 u burgos si organizator i Kongresit të Tivarit, ku u themelua Partia e Re Komuniste e Jugosllavisë (bolshevike). U lirua nga burgu më 1985 dhe më pas punoi në Institutin e Historisë të Kosovës në Prishtinë. Botoi punime shkencore në revistat lokale për Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe për Luftën Nacionalçlirimtare. Në vitin 1991 ishte mbështetës i masave të dhunshme në institucionet e Kosovës. Pas vitit 1999 u shpërngul në Beograd. (Mrika Limani)

BOSHNJAKISHTJA. Variant i standardizuar i gjuhës sllave të jugut, që përdoret nga boshnjakët në Bosnjë dhe Hercegovinë (prej rreth 2, 2 milionë), por flitet edhe në Sanxhak (Serbi), në Mal të Zi, në Kroaci, në Kosovë, në Slloveni e Maqedoni dhe në diasporën boshnjake. Përveç në Bosnjë dhe Hercegovinë, boshnjakishtja ka status zyrtar edhe në Serbi, në Kosovë dhe në Mal të Zi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, bashkë me boshnjakishten, gjuhë zyrtare janë edhe serbishtja e kroatishtja. Dallimet ndërmjet këtyre tri gjuhëve janë të vogla. Boshnjakishtja përdor më shumë orientalizma. Zyrtarisht, boshnjakishtja u dallua si gjuhë e veçantë mbi bazë të variantit të serbokroatishtes që përdorej në Bosnjë e Hercegovinë pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar. U njoh nominalisht si gjuhë zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 1994. Boshnjakishtja standarde bazohet në dialektin e shtokavishtes. Shkruhet me alfabet latin dhe cirilik. (Kadire Binaj)

BOSHNJAKU Florent (1970-). Kompozitor e producent muzikor. Lindi në Gjakovë. Kreu Shkollën e Ulët të Muzikës dhe gjimnazin në Prishtinë, studimet në “SAE Institute” për inxhinier zëri në Nju-Jork, ndërsa teknologjinë muzikore në “School of performing arts” në Londër. Është anëtar i Shoqatës së audioinxhinierëve në SHBA, me një përvojë 30-vjeçare. Në katalogun muzikor prodhuar në studion e tij dëgjohen hite trojesh shqiptare e më gjerë. Përvoja shumëvjeçare, përpos kompozimit, është e gërshetuar me ndërlidhje aktivitete muzikore: drejtor artistik i festivaleve “Show Fest” (2002-2003) dhe “Video Fest” (2005-2012), themelues e drejtor i Shoqatës për Administrim të së Drejtës së Autorit në Kosovë “APIK” 2011, pjesëmarrës në Festalet: “Eurosong” (Baku), “Montreux Jazz Fest” dhe në festalet e vendit nga vitet ’80. Tingujt e tij muzikorë dëgjohen edhe në radiodrama, muzikë për reklama, në filma dokumentarë e të metrazhit të shkurtër. Në krijimtarinë e tij hyjnë dhe këngët me dedikim të posaçëm me tema sociale, me aktivitete të gjera e bashkëpunime me artistë-këngëtarë të njohur. (Arnisa Rexhepi)

BOSHNJAKU Nexhat (1941-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Makinerisë në Beograd (1964). Studimet pas-universitare i kreu po në Beograd, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbaroi në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimit në Zagreb (1980). Si inxhinier i makinerisë filloi të punojë në fabrikën “Metaliku” në Gjakovë. Krahas punës në prodhim, mori pjesë edhe në procesin mësimor, në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1974 u zgjodh docent, më pas profesor inordinar dhe profesor ordinar (1983). Kontribut të veçantë dha si bashkëpunëtor profesional në Fabrikën e Amortizatorëve, në Fabrikën e Elektromotorëve në Gjakovë si edhe në Fabrikën “Energoinvest” në Obiliq. Luajti rol të rëndësishëm në bashkëpunimin e Fakultetit me



NEXHAT
BOSHNJAKU

industrinë, që rezultoi me realizimin e projektit për dizajnimin automatik të amortizatorëve, gjë që u kurorëzua me shumë diploma, tema magistrature dhe doktorate. Është autor i tekstit “Njohuri materialesh të makinerisë” (1981). (Hysni Osmani)

BOSHNJAKU Skënder (1942-). Mjek, neuropsikiatër, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet i mbaroi në Fakultetin



SKËNDER
BOSHNJAKU

e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit (1967). U punësua në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, më vonë kreu specializimin nga neuropsikiatria dhe sub-specializimin nga elektroencefalografia. Në vitin 1974 u zgjodh asistent i lëndës së neuropsikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, në vitin 1980 mbrojti disertacionin e doktoratës dhe po atë vit u emërua docent, e më pas profesor inordinar dhe profesor ordinar (1995). Ishte sekretar për Shëndetësi të Kosovës dhe drejtor i Klinikës së Neuropsikiatrisë, nga ku u shkarkua në vitin 1990. Publikoi shumë punime shkencore dhe profesionale, si autor dhe bashkautor. Ka shkruar edhe tekste kritike, recensione për artin figurativ. Me tekste publicistike për artet figurative ka botuar librat: “Shënime për pikturën” (1987), “Anatomia e gjuhës figurative” (1988) dhe “Shtegtime”. (Jusuf Telaku)

BOSHNJAKU Tahir Efendi (1770-1850). Njihet edhe si Tahir efendi Gjakova dhe Tahir efendiu i Madh. Lindi në Llukare, afër Jeni Pazarit. Pas mbarimit të studimeve në Stamboll, punoi si myderriz në Medresenë e Vogël të Gjakovës. Emri i tij zgjoi interesim pas botimit të veprës “Vehbije” (Dhuratë) më 1907 në Sofje. Kjo vepër, e shkruar shqip në vitin 1835, në poezi e prozë, tërhoqi dhe gjuhëtarët Idriz Ajetin e Eqrem Çabejn, të cilët çmuan kontributin e tij për pasurimin e gjuhës letrare shqipe me fjalë të reja. Vepra tjetër shqip e tij mban titullin “Tefsir-ul ajat ‘ala lisan-il arnaud” (Koment i ajeteve në gjuhën shqipe). Për këtë dorëshkrim ka mbetur vetëm një shënim bibliografik i H. Kaleshit, ku thuhet se ka 28 faqe të papaginuara, është format xhepi dhe shtjellon

problemin e gjakmarrjes dhe dëmin që sjell ajo. Por janë gjetur dhe katër vepra të panjohura të tij në dorëshkrim, tri në gjuhën osmane: “Kitab-i Tenbihije” (Libri i paralajmërimeve) ka 51 faqe, “Hyda Rabbim” (Zoti, Krijuesi im) vepër poetike nga apologjetika islame dhe “Hazine-i Din” (Thesari i Fesë) në vargje; si dhe një në gjuhën arabe, që nuk ka titull, por që shtjellon namazin dhe mund të quhet “Libër mbi namazin”, që ka 56 faqe. Tahir Gjakova ishte poet që shkroi shqip, turqisht e arabisht, intelektual e myderriz i shquar, lëvrues i gjuhës shqipe. (Abdullah Hamiti)

BOSHNJAKU-BEGOLLI Drita (1964-). Aktore, mësimdhënëse universitare, regjisore. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, kurse u diplomua në Fakultetin



DRITA BOSHNJAKU
-BEGOLLI

e Arteve të Universitetit të Prishtinës, në degën e regjisë së teatrit. Që nga viti 1981 punoi si aktore në Teatrin Popullor Krahinor (TPK), ndërsa u shqua që herët me interpretimin e rolit të Ofelisë në shfaqjen “Hamleti” (1982) të këtij teatri. Më pas realizoi nëntë rolet kryesore në ciklin dramatik “Bregu i pikëllimit” të T. Dërvishit, inskenuar nga TPK-ja (1987). Nga rolet e interpretuara pas vitit 1999 do veçuar edhe roli kryesor në shfaqjen “Aleksandër Moisiu” (2006) të M. Ramadanit. Gjithashtu është regjisore e disa shfaqjeve teatrore: “Natën e mirë, nënë” në Teatrin “Dodona”, “Duke pritur Godonë” në TTK etj. Për rolet e interpretuara dhe shfaqjet e vendosura në skenë mori mirënjohje dhe çmime në festivale. Është aktore e përhershme në Teatrin Kombëtar dhe mësimdhënëse e lëndës regji teatri në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Ishte edhe prorektore në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. (Besim Rexhaj)

BOSHTRA (FYSHTRA). (*Forsythia europaea* Degët Bald). Shkurre e familjes ullaore (*Oleaceae*), relik i terciarit dhe lloj endemik i Gadishullit Ballkanik i përhapur në Shqipëri dhe në Kosovë. Rritet në tokat serpentinore me shumë dritë e diell të lartësisë mbidetare nën 1, 000 m. Është e lartë rreth 2-5 m, me gjethe rënëse, të përkundërta, vezake deri vezake heshtore të




BOSHTRA

plota ose buzë të sharrëzuara. Lulet e verdha të vendosura në lulesa sqetullore, me kupë e kurorë katëranëtarëshe. Fryti kapsollë rreth 1.5 cm i gjatë. Lulëzon para ose në të njëjtën kohë me gjethtësimin, në muajt prill-maj, kurse frytet arrijnë në vjeshtë. Ka lloje të boshtres që kultivohen si bimë dekorative për lulet intensive të verdha që veçohen deri diku për dukurinë e kauliflorisë. Ky element endemorelikt me kohë ka zgjuar interesim të madh të shkencës. Atë për herë të parë e zbuloi Balldacci (1897) në zonën e Mirditës, në Shqipërinë Veriore. Deri vonë është menduar se në Kosovë gjendet në Gubavec, afër Pejës, ku e përshkroi Csiki (1917). Kërkimet e mëvonshme kanë treguar se boshtira ka shtrirje të madhe në territorin e Kosovës, duke krijuar shkurre që mbulojnë sipërfaqe të mëdha në lokalitetet: Ponoshec, Mulliq, Junik, Morinë në rrethin e Gjakovës, e sipërfaqe edhe më të mëdha mbulon në malet e Zatriqit (Llapqevë, Mrasor) të rrethinës së Rahovecit. Në formacionet bimore të boshtres marrin pjesë rreth 100 lloje të shkurreve barishtore të ndryshme, në mes të të cilave edhe endemorelikte të ndryshme, që i japin vlerë të madhe shkencore kësaj bashkësie bimore. (Feriz Krasniqi)

BOSHTRAKAJ Gonxhe (1972-). Aktore, mësimdhënëse universiteti. Lindi në Pejë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, kurse studimet për aktrim në Prishtinë. Është ndër aktoret e gjeneratës së parë të degës së aktrimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, që u arsimua në kushtet e mësimin paralel në vitet '90. Luajti në shfaqjet "Kufiri me atdhe" (1992), "Vdekja dhe vasha" (1993) si dhe në filmin televiziv "Rrugua pa kthim" (1993). Gjatë viteve '90 migroi në Gjermani, ku kreu studime dhe hulumtime në teatrologji, filozofi, sociologji dhe psikologji. Në vitin 2010 kreu doktoratën në filozofi, në Universitetin e Konstancës (Gjermani), me temën "Teatri si model për analizën e një shoqërie të getoizuar (Kosova 1989 - 2009)". Botoi shkrime dhe përkthime në revistat teatrore. Jeton në Shtutgart (Gjermani) dhe është pedagoge në Universitetin e Konstancës. (Visar Krusha)

BOVAN Vladimir (1927-). Historian i letërsisë serbe nga Kosova, publicist. Lindi në Jasen të Ferizajt. Mbaroi studimet e letërsisë jugosllave në Universitetin e Shkupit. Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Filologjisë në Beograd. Ishte profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Mori pjesë në tubime shkencore. Botoi një sërë veprash nga fusha e studimit të folklorit të serbëve në Kosovë. Botoi: "Letërsia popullore e serbëve në Kosovë dhe Metohi" (10 vëllime, 1980), "Antologji e këngëve epike popullore serbokroate" (1989), "Këngët lirike dhe epike të Kosovës e Metohisë" (2000-2003), "Dasma serbe në Kosovë e Metohi" (2004), "Shkolla Teologjike e Prizrenit" (2005). Jeton në Obrenovc, Serbi. (Ismet Markoviq)

BOZAXHI Arif (1944-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prishtinë. Në Prishtinë kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike për gjuhë dhe letërsi turke (1968), ndërsa në



ARIF BOZAXHI

Fakultetin e Filologjisë u diplomua në degën e orientalistikës (2003). Në vitet 1973-1987 në gazetën "Tan" ishte gazetar dhe redaktor i faqeve të kulturës, pastaj kryeredaktor i revistës "Çevren" dhe i redaksisë së botimeve "Tan".

Më pas (1987-1993) ishte koordinator në Bibliotekën e qytetit "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë. Më 1993 emigroi në Gjermani, pas luftës u kthye në Kosovë dhe gjatë viteve në vijim kreu detyra të ndryshme në institucionet e Kosovës, si koordinator për marrëdhënie me Turqinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës etj. Federata Ndërkombëtare e Paqes më 2008 e emëroi Ambasador të Paqes për Kosovë dhe Ballkan. Me krijimtari letrare filloi të merret qysh herët. Publikoi një sërë vëllimesh me poezi: "Zogu i paqes" (1975), "Pranverë e syrgjynosur" (1982), "Hiri i lotit" (1996), "Liria dhe pranvera e syrgjynosur" (2004), "Flutura në grila" (2006) etj. Poezitë e tij u botuan edhe në shqip dhe gjuhë të tjera. (Irfan Morina)

BOZHIQ (Božić) Ivan (1915-1977). Historian serb, profesor i Fakulteti të Filozofisë në Beograd, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë. Lindi në Makarska

(Kroaci), ndërsa gjimnazin klasik e kreu në Dubrovnik. Studimet për histori i kreu në Fakultetin e Filozofisë në Beograd, ku edhe u doktorua në vitin 1951. Ishte ekspert i historisë mesjetare të Zetës dhe trevave bregdetare të Adriatikut. Gjatë veprimtarisë së tij studimore kreu hulumtime arkivore në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut, Arkivin Historik të Kotorrit, si dhe në arkivat italiane dhe franceze. Shquhet për një trajtim të veçantë të çështjeve që i referohen historisë mesjetare të bregdetit malazez dhe viseve të Arbërisë Veriore. Në këtë drejtim ai trajton tema që janë studiuar pak nga historianët e tjerë, si ato që lidhen me organizmin fisnor, katunet, si dhe mbi marrëdhëniet agrare në zonat malore dhe në prapatokën e qyteteve bregdetare. Veprat më të njohura të tij janë: “Dubrovniku dhe Perandoria Osmane në shek. XIV dhe XV” (1952), “Bregdeti i shqetësuar i shekullit XV” (1979) etj. (Muhamet Mala)

BRADA Riza (1935-). Veprimtar i arsimit, punonjës shkencor. Lindi në Pejë, ku kreu edhe shkollën fillore. Gjimnazin e ulët e kreu në Mitrovicë, ndërsa shkollimin e mesëm në Pejë, për-



RIZA BRADA

katësisht në Gjakovë dhe Prizren. Studioi pedagogjinë në Universitetin e Shkupit. U doktorua më 1981 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punën profesionale e filloi si mësues, pastaj arsimtar i gjuhës shqipe, vazhdoi si drejtor i shkollës fillore në Jabllanicë të Vogël. Ishte mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Normalen e Pejës dhe i lëndëve filozofike në Gjimnazin e Deçanit, drejtor i shkollës fillore dhe inspektor arsimit në Pejë, këshilltar pedagogjik dhe drejtor i Entit Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit në Prishtinë. R. Brada është autor ose bashkautor tekstesh të shkollës fillore. Publikoi një varg artikujsh profesionalë-shkencorë nga fusha e arsimit. Botoi disa vepra nga fusha e pedagogjisë familjare, parashkollore dhe shkollore, si: “Metodika e diturive të para nga matematika” (1972), “Zgjidhja pedagogjike e situatave konfliktuale te nxënësit e moshës së re shkollore” (1984), “Pedagogjia shkollore” (1994), “Pedagogjia familjare” (1995), “Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore” (2000), “Di-

daktika” (2007), “Didaktika kibernetike” (2010), “Pedagogjia” (2012) etj. (Afërdita Deva-Zuna)

BRAHA Haki (1950-1999). Gazetar. Lindi në Stagovë të Kaçanikut. Arsimin fillor e mori në vendlindje, të mesmin në Kaçanik, Shkollën e Lartë Pedagogjike e mbaroi në Gjakovë. Punoi në arsim dhe pastaj si gazetar i “Rilindjes”, ndërsa më 1978 nis punë në TV Prishtina. Pas demonstratave të vitit 1981 pezullohet nga puna, por më 1989 rikthehet. Në korrik të vitit 1990 mbetet pa punë, bashkë me kolegët e tjerë shqiptarë, pas mbylljes nga Serbia të kësaj shtëpie televizive. Gjatë punës si gazetar raportoi për zhvillimet politike, ekonomike dhe kulturore në komunën e Ferizajt. U mor edhe me krijimtari letrare. Më 26 mars të vitit 1999 rrëmbehet nga forcat ushtarake dhe policore serbe dhe u gjet i vrarë në rrugën Ferizaj-Prishtinë. (Zenun Çelaj)

BRAHA Meriman (1946-). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, i burgosur politik. Lindi në Prizren. Shkollën fillore, të mesme dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike i kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin Filozofik në Prishtinë (1974). Punoi si mësimdhënës në Korishë të Prizrenit, pastaj në Gjilan dhe Prishtinë (1968-1981). Ishte organizator i demonstratës të vitit 1968 në Prizren. Ishte pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981 dhe dënohet me 7 vjet burg. Në mars të vitit 1989 merret në izolim nga organet shtetërore për 3 muaj. Më 1990 u përfshi në organizimin politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe më pas ishte ndër themeluesit e Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri”. Më 1991 nga Ministria e Arsimit e Qeversisë së Kosovës në emigrim emërohet koordinator për mësimin plotësues në diasporë. Në vitet '90 qëndron në Shqipëri dhe bëhet koordinator i unifikimit të sistemit të arsimit Kosovë-Shqipëri. Ishte bashkautor i teksteve të mësimin plotësues në diasporë për mësimet fillestare të gjuhës shqipe. Pas luftës emërohet zyrtar për mësim plotësues në diasporë, në kuadër të departamentit për çështje jorezidente të Ministrisë së Kulturës, më pas zëvendës drejtor i Muzeut të Kosovës (2006). Është drejtor ekzekutiv i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës (2012). (Fehmi Rexhepi)

BRAHA Sefedin (1953-). Trajner i boksit. Lindi në Vinarc të Mitrovicës. Kreu Shkollën e Lartë të Boksit në Sarajevë në vitin 1986.

Punën e trajnerit të boksit e nisi në klubin e boksit “Trepça” të Mitrovicës. Më pas kalon te KB “Prishtina”, një vit si zëvendëstrajner, e më pas trajner profesionist (1979 – 1989). Ishte pjesë e “Prishtinës”, kur ajo arriti sukseset më të mëdha në boksën amator. U largua nga Prishtina, kur u instaluan masat e dhunshme dhe u bë trajner i “Zhelezniçarit” të Sarajevës dhe më vonë i “Radniçkit” të Sllavonski Bordit (Kroaci). Në vitin 1992 shkoi në Munihi të Gjermanisë, ku u bë trajner në klubin “MTK” (1992-2010). Ishte edhe pjesë trajnerëve të përfaqësueses së Gjermanisë për grupmosha të reja (shpresat) në vitin 2006. Jeton dhe punon në Gjermani. (Florim Maliqaj)

BRAHIMAJ Ahmet (1953-). Balerin. Lindi në Novosellë të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Shkollën e Mesme të Baletit në Shkup (1972). I takon gjeneratës së parë të



Baletit të Kosovës. Si balerin i këtij ansambli luajti në të gjitha shfaqjet e baletit, të cilat në vitet '70 dhe '80 janë punuar në skenën e Tetarit Krahinor të Kosovës (TKK), përkatësisht në 38 premiera të baletit.

Në shumicën e këtyre shfaqjeve interpretoi rolet kryesore, në mesin e të cilave në shfaqjet “Karmen”, “Romeo e Zhuljeta”, “Era dhe Kolona”, pastaj në shfaqjet “Kopelia”, “Don Kishoti”, “Halili e Hajria”, “Kënga e Rexhës”, “Besë”, “E bukura More” etj. Në vitin 1985 u emërua shef i trupës së baletit në TKK. Pas luftës ishte njëri nga iniciatorët për rithemelimin Baletit të Kosovës. Së bashku me disa nga kolegët e tij, në kuadër të shkollës së muzikës “Prenkë Jakova” në Prishtinë, hap Shkollën e Mesme të Baletit. Klasa e tij u diplomua në vitin 2005 dhe ajo është gjenerata e parë pasluftës, si dhe bërthama e gjeneratës së re të Baletit të Kosovës. Për kontributin e dhënë në zhvillimin e artit të baletit në Republikën e Kosovës mori çmime dhe mirënjohje. Në vitin 2013 në Festivalin Ndërkombëtar të Vallëzimit të Italisë “Alto Joni Dance Festival” u nderua me çmimin e karrierës. (Besim Rexhaj)

BRAHIMAJ Naser (1976-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Jabllanicë të Gjakovës. Pas rezistencës kundër policisë serbe në Jabllanicë

më 9 mars 1993 përfshirja e tij në organizimin e rezistencës u bë më intensive. Gjatë periudhës së ilegalitetit kreu disa aksione kundër forcave serbe. Shumë herë udhëtoi për armatim në Shqipëri me bashkëluftëtarë të tjerë. Gjithashtu mori pjesë në aksionin e përgjithshëm të UÇK-së më 11 shtator 1997 kundër stacionit policor në Çallapek të Pejës. Pas fillimit të luftës frontale, për një kohë ishte njëri nga koordinatorët e UÇK-së për fshatrat e Dushkajës. Mori pjesë në betejat e zhvilluara që nga prilli i vitit 1998, si në Cërmjan, Sukë të Cermjanit, Kralan, Kpuz, Qeskovë, Grabanicë, Bokshiq, Vranoc, Loxhë, Kryshec, Gërgoc, Broliq, Maznikë, Ratis, Dashinoc, Glllogjan, Lumbardh, Pozhar dhe në aksione të armatosura të kryera në prapavijë të armikut. Ishte epror i Brigadës 132 “Myrtë Zeneli”. Ra dëshmor në betejën për mbrojtjen e Jabllanicës më 5 prill 1999. (Fetnete Ramosaj)

BRAJAN Xhozef (Joseph Brian) (1951-). Gjuhëtar amerikan, profesor universiteti. Diplomoi në Universitetin Yale (1973), ndërsa ka doktoruar në Harvard (1978). Është profesor i Universitetit të Shtetëror të Ohajos (OSU). Ka qenë redaktor i revistës “Language” si dhe redaktor i publikimeve të ndryshme, organizues i simpoziumeve dhe konferencave shkencore. Është bashkëredaktor (me R. Janda) i librit “Manual i gjuhësisë historike” (The Handbook of Historical Linguistics) dhe bashkautor (me V. Fridman) i librit për gjuhësinë ballkanike. Studimet e tij lidhen me historinë e gjuhës, me ndryshimet e gjuhëve. Ka shkruar edhe artikuj që lidhen me shqipen dhe historinë e saj. Monografia e tij “Sinkronia dhe diakronia e paskajores së Ballkanit” (Synchrony and Diachrony of Balkan Infinitive, 1983) merret edhe me paskajoren e shqipes. Është anëtar i redaksisë së revistës “Albanohellenica” në Tiranë. Ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Prishtinës dhe ka shkruar artikuj që lidhen me çështje të strukturës gramatikore të shqipes në raport me gjuhët e Ballkanit. (Lindita Rugova)

BRAJSHORI Esat (1964-). Regjisor. Lindi në Sharban të Prishtinës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Mbaroi studimet për regji teatri në Fakultetin e Artit Skenik të Akademisë së Arteve të Bukura, në Tiranë. Gjatë viteve '90 punoi si regjisor në Televizionin Shqiptar (Programi Satelitor) në Tiranë. Është autor i disa filmave dokumentarë. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës ka bërë regjinë e shfaqjeve:

“Repriza e lirisë” (2003), “Ku është populli” (2004) dhe “Mendohu Xhakomino” (2005). Ka qenë deputet i Aleancës Kosova e Re në legjislaturën e tretë të Kuvendit të Kosovës. Për një kohë shërbyeu në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë. (Naime Beqiraj)


BRENDI. Sistem identiteti, një imazh në mendjen e konsumatorit, një sistem vlerash, një personalitet, një vlerë e shtuar, një përfshirje e identitetit dhe e raporteve, e parë më së shumti si një atribut ose si një produkt i ofruar në treg, një besim në perceptim. Konsumatorët priren gjithnjë e më tepër drejt blerjes së markave globale. Brendet, përkatësisht markat janë më shumë se logo, janë edhe më se një produkt. Ato përfaqësojnë emocione, qëndrime, vlera, por edhe stilin e të jetuarit të një shoqërie në vende të ndryshme të botës. Markat vazhdojnë të jenë edhe sot një nga asetet kryesore të kompanive. Konsumatorët krijojnë një afri me to, fillojnë t’u besojnë atyre dhe të marrin vendime më të shpejta për blerjen e markave, ndërsa realisht besojnë në superioritetin e tyre. Derisa kompanitë janë pronare të markave, markat jetojnë në mendjen e konsumatorëve të tyre ose të konsumatorëve potencialë. Markat tregtare mbrohen me ligj, si një komponentë e pronësisë industriale. Aplikimi për regjistrimin e markave tregtare në Kosovë ka filluar që nga viti 2007 në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, në Zyrën për Pronësi Industriale, që tani është shndërruar në Agjenci për Pronësi Industriale. Që nga viti 2007 e deri më tani janë bërë rreth 24,000 aplikime për markë tregtare, nga të cilat tashmë janë të regjistruara afërsisht 15,000 marka tregtare. Shumica e aplikimeve janë bërë nga kompanitë e shteteve të industrializuara të Europës dhe nga SHBA-ja. (Nail Reshidi)

BRESANA. Fshat në komunën e Dragashit, 15 km në verilindje të tij. Shtrihet në fushëgropën e Opojës, në lartësi mbidetare 1120 m. Si vendbanim përmendet në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 14.34 km², nga e cila pjesa më e madhe është e mbuluar me pyje dhe kullosa (rreth 60%), kurse arat dhe livadhet zënë 33% të territorit. Bresana u përfshi nga valët e emigrimit të popullsisë brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, për shkak të lëvizjes pozitive natyrore, popullsia shënoi rritje të vazhdueshme. Derisa në vitin 1948 Bresana

kishte 1219 banorë, në vitin 2011 ajo ka 2839 banorë. Popullsia merret me blegtori, bujqësi, tregti, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ndodhet në botën e jashtme. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Zaplluxha, Blaçi, Kuklibegu, Zgatari, Buzezi, Kuki dhe Kosava. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9-vjeçare, shtëpinë e kulturës, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare, shoqëri kulturore amatore etj. (Hasim Kryeziu)

BRESTOVCI Behlul (1941-). Defektolog. Lindi në Gjilan, ku mbaroi gjimnazin, ndërsa studimet për pedagogji speciale i mbaroi në Beograd, ndërsa në Zagreb mbaroi Fakultetin e Defektologjisë. U magjistrua në Fakultetin e Kulturës Fizike në Zagreb shkencat kinezologjike (1975), ndërsa disertacionin e doktoratës për defektologji e mbrojti në Fakultetin e Defektologjisë në Zagreb (1979). Nga viti 1969 punoi në Fakultetin e Defektologjisë në Zagreb si asistent, docent, ndërsa në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë si docent nga 1982, profesor inordinar në Zagreb dhe në Prishtinë dhe profesor ordinar në Zagreb nga viti 1998. Ka mbajtur mësim për studimet pasuniversitare në Zagreb, në Prishtinë, në Lubjanë dhe në Tuzëll. Ka botuar: “Belbëzimi: të folurit, inteligjenca, antropometria, motorika, anksioziteti” (shqip, 1988); “Logopedia: shkencë për patologjinë e komunikimit të folur-gjuhësor” (kroatisht, 1992); “Ndërlidhjet e ‘fjalës dhe fjalissë së parë’ me aftësitë kognitive” (shqip, 1991), si dhe një numër studimesh nëpër revistat shkencore profesionale. Ka qenë kryeredaktor i revistave “Acta defectologica” dhe “Logopedija” në Zagreb dhe anëtar redaksie në më shumë revista. Ka qenë dekan i Fakultetit të Defektologjisë në Zagreb. (Redaksia)

BRESTOVCI Faik (1942-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, kurse Fakultetin Juridik e kreu në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, ku mbrojti tezën e doktoratës (1980). Po atë vit u zgjodh profesor inordinar, kurse në vitin 1993 profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Ishte drejtor i Institutit për Kërkime Juridike-Shoqërore



FAIK BRESTOVCI

shkencore dhe tekste universitare (“E drejta procedurale civile I, II”, 1988, 1997 etj.). (Nerxhivane G. Dauti)

BRESTOVCI Sadullah (1930-1979). Historian. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën normale në Gjakovë (1953). Punoi mësues disa vjet. Pas

SADULLAH
BRESTOVCI

diplomimit për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, punoi mësime në historinë gjimnaziale dhe Shkollën Normale të Gjilanit, pastaj drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike në Gjilan dhe në vitin 1966 vazhdoi punën e mësimeve në lëndën e historisë në Shkollën Normale të Prishtinës. Më pas kreu studimet pasuniversitare po në Fakultetin Filozofik në Beograd (1972) dhe magjistroi me temën “Marrëdhëniet serbo-shqiptare prej Tanzimatit e ‘Naçertanisë’ së Ilija Garashaninit gjër të lufta serbo-turke të viteve 1876-1878”. Në vitin 1968 u zgjodh asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Mori pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ishte shef i degës së historisë dhe sekretar i revistës “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave historike, ku edhe botoi një varg punimesh shkencore. Vdiq në spitalin e Nishit, pas një sëmundjeje të shkurtër dhe të rëndë. Veprat kryesore që u botuan pas vdekjes së tij janë: “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe-malazeze (1830-1878)” (1983) dhe “Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit, Islam Pira (1866-1931)” (2008). (Fitim Rifati)

BREZNICA Lam (1908-2002). Veprimtar dhe luftëtar antikomunist. Lindi në fshatin Breznicë, të Bujanocit. Si i ri u kundërvu pushtetit të Mbretërisë Jugosllave. Pas rënies së Jugosllavisë

më 1941, u bashkua xhandarmërisë shqiptare. Më pas shkoi në Tiranë, ku emërohet oficer për ushtrimin e ushtarëve të rinj. Gjatë kësaj kohe përfshihet në Lidhjen Popullore Shqiptare dhe në Komitetin e Kosovës. Një kohë u transferua në Shkodër dhe më pas sërish u kthye në Tiranë. Në marrëveshje me udhëheqësit e regjimentit të Kosovës, në krye me Pajazit Boletin, në pranverë të vitit 1944 nga Tirana u kthye në fshatin e lindjes, me qëllim të organizimit të mbrojtjes së Kosovës Lindore nga depërtimi i forcave partizane serbe, maqedone e bullgare. Në bashkëpunim me prijësit lokalë arritën të krijojnë çetat dhe batalionet vullnetare, të cilat gjatë muajve qershor-nëntor 1944 zhvilluan luftime për mbrojtjen e kufijve lindorë të Shqipërisë Etnike. Pas vendosjes së pushtetit komunist (16 nëntor 1944) u arratis në malet e Bujanocit, ndërsa në vitin 1946 u bashkëngjiti Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH) të Anamoravës. Deri në vitin 1948 jetoi i fshehur në mal kur u detyrua të dorëzohet, për shkak të familjes që i ishte marrë peng. U dënua me 10 vjet burg të rëndë. Pas daljes nga burgu u angazhua në proceset politike dhe emancipuese në Kosovën Lindore. (Adem Murati).

BRËNKUSH Grigore (BRËNCUŞ Grigore) (1929-). Gjuhëtar e filolog rumun, albanolog. Kreu studime për filologji në Universitetin e Bukureshtit dhe më pas bëri specializim në Shqipëri (1958-1959, 1965, 1972). Doktoroi më 1968 me tezën “Marrëdhënie gjuhësore rumune-shqiptare”. Ishte shef i katedrës së gjuhës rumune në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Bukureshtit (1973-2001), nënkryetar i Shoqatës së Shkencave Filologjike (filiali i Bukureshtit) dhe anëtar i Komitetit të Shoqatës Rumune për Linguistikë. Fushat e tij kryesore studimore janë: filologjia rumune, historia e kësaj gjuhe, dialektologjia, gjuha letrare e sotme rumune, leksikologjia, marrëdhëniet e shqipes me rumanishten. Ndër studimet e tij me rëndësi edhe për albanistikën janë: “Fjalori autokton i gjuhës rumune” (1983), “Elementet e përbashkëta rumune-shqiptare” (1987), “Studime rreth fondit trako-dak të gjuhës rumune” (1995), “Konkordanca linguistike rumune-shqiptare” (1999). Ka përkthyer rumanisht veprën e Migjenit. (Mensur Vokri)

BRIGADA 141 “MEHË UKA”. Njëra nga dy brigadat e Zonës Operative të Shalës, ethemeluar

më 30 qershor 1998 në fshatin Bare të Shalës. Komandant i saj u emërua Hysni Ahmeti, kurse zëvendëskomandant Zymer Halimi-Besi. Brigada operoi në rajonin e Shalës së Bajgorës dhe pati shtrirje në 60 fshatra të komunave Mitrovicë, Vushtrri, Leposaviq etj. Brigada kishte 4 batalione, njësinë speciale, njësinë për ndërhyrje të shpejtë, policinë ushtarake dhe sektorin e personelit, të operativës, të zbulim-kundërzbulimit, të logjistikës, të ndërlidhjes etj. Veprimtaria e saj luftarake u shtri nga 10 korriku 1998 (me betejën e Mazhiqit) deri më 19 qershor 1999, kur çliroi minierën e “Trepçës” në Stantërg. Betejat kryesore që u zhvilluan nga kjo brigadë ishin beteja e Mazhiqit, e Majdanit, Melenicës, Pasomës, e Kaçandollit, e Dumincës, Samadrexhës etj. Ishte brigadë që ia rriti prestigjin UÇK-së, sidomos me aktin e zënies rob të një skuadre të ushtrisë serbe (7 ushtarë dhe 1 oficer) më 8 janar 1999, duke e detyruar palën serbe të pranojë këmbimin e robërve të luftës, me ç’rast 9 pjesëtarë të UÇK-së u liruan nga burgjet serbe. Kjo brigadë me 1,377 pjesëmarrës i dha Kosovës 3 heronj dhe 60 dëshmorë. Pas luftës pjesëtarët e kësaj brigade u ngarkuan me pozita të larta në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Miftar Kurti)

BRIGADA E DRENICËS (1944-1945). U formua në mesin e dhjetorit 1944. Komandant i saj u zgjodh Shaban Polluzha, i cili kishte bashkëpunuar me Lëvizjen Antifashiste Çlirimtare në Kosovë. Ajo kishte 700-1,000 veta, si dhe trupojën dhe gardën prej 40 vetash. Në fillim kishte katër batalione, më vonë gjashtë. Luftëtarët nuk kishin uniformë, prandaj veshmbathjen, ushqimin dhe armatimin i siguronin vetë. Brigada mbante flamurin shqiptar pa yll, ndërsa në kapela luftëtarët mbanin shqiponjën dykrenore. Me urdhrin e Shtabin Operativ të Kosovës më 17 janarit 1945 Brigada e Drenicës iu bashkëngjit Brigadës VII të Kosovës, e cila do të nisej për në frontin e Sermit në veri të Jugosllavisë. Udhëheqja jugosllave me këtë rast kishte bërë plane për zhdukjen e kësaj njësie, prandaj marshimin e saj për në drejtim të Sremit nuk do ta lejonte si formacion kompakt, por të ndarë në kolona, me kohënise të ndryshme dhe të kontrolluar nga formacionet ushtarake serbe. Ndërkohë u njoftua për terrorin e dhunën e ushtruar nga reparte jugosllave mbi popullsinë e Drenicës dhe të rajoneve të tjera të Kosovës. Kjo

shkaktoi revoltë në efektivat e kësaj brigade dhe ato kundërshtuan urdhrin për marshimin në Veri. Për këtë shkak, Shtabi Operativ dhe Shtabi i Divizionit të 46-të Serb, natën e 23-24 janar, 1945, urdhëruan bllokimin e fushës së Podujevës dhe morën masa për asgjësimin e forcave të Shaban Polluzhës. Pas luftimeve të zhvilluara në shpatet e Çiçavicës, Brigada e Drenicës çau rrethimin dhe arriti në Drenicë. Kundër shqiptarëve të armatosur vetëm me nga një pushkë u angazhua artileria e aviacioni. Veprimet luftarake u shoqëruan me masakrimin dhe grabitjen e popullsisë. Gjatë kësaj kohe u vranë dhe u plagosën rreth 430 luftëtarë, u dogjën dhe u plaçkitën 450 shtëpi, si dhe u konfiskua i tërë ushqimi e bagëtia në fshatrat e Drenicës, të Vushtrrisë dhe të Mitrovicës. (Izber Hoti)

BRIGADA IV (VII) SHQIPTARE E MAQEDONISË PERËNDIMORE. Njësit-partizane, e themeluar në gusht të vitit 1944 në malin Karaorman të Maqedonisë, me luftëtarë nga Dibra, Struga, Kërçova, Gostivari, Tetova, Manastirit dhe Resnja. Në fillim njihej si Brigada IV e më vonë emërtohet Brigada VII Sulmuese Shqiptare në Maqedoni. Mori pjesë edhe në çlirimin e Jugosllavisë në kuadër të Divizionit të 42-të të Korparmatës së 16-të të Jugosllavisë. Me rastin e themelimit komandat u zgjodh Nafi Sulejmani, komisar politik Qemal Agolli, zëvendëskomandant Shahin Mehmeti, zëvendëskomisar Xhafer Kodra, Shef i shtabit Miftar Jegeni, përgjegjës i rinisë Murteza Kadzadeu, kurse përgjegjës për sigurim Taip Taipi. Shumica e kuadrit të Brigadës IV ishin arsimtarë nga Shqipëria, që kishin punuar në viset shqiptare të Maqedonisë. Me rastin e themelimit Brigada numëronte afër 500 luftëtarë, ndërkohë numri u rrit në 2,000 luftëtarë shqiptarë. Brigada mori pjesë në çlirimin e shumicës së qyteteve të Maqedonisë, të Gjilanit dhe Preshevës. Ajo disa herë ndërhyri për t’i ndaluar krimet e elementeve serbo-bullgare ndaj shqiptarëve. Në janar të vitit 1945 në Preshevë u bë riorganizimi i Brigadës dhe prej saj u formuan Brigada VII Sulmuese dhe Brigada Plotësuese. Ato luftuan kundër forcave gjermane deri në Vinkovc dhe Zagreb të Kroacisë. Nga kjo brigadë hero i popullit u shpall Liman Kaba. (Riza Sadiku)

BRIGADAT PARTIZANE TË KOSOVËS (I-VIII). Njësit-partizane që u themeluan dhe vepruan në Kosovë gjatë Luftës së Dytë

Botërore. Deri në fund të luftës, nga luftëtarët e Kosovës u krijuan gjithsej 8 brigada dhe një korpus i Mbrojtjes Popullore Jugosllave.

Brigada I Kosovare u formua më 12 qershor 1944 dhe u shpërbë në korrik të vitit 1945. Me rastin e formimit, Brigada kishte 2 batalione. U formua në fshatin Zbrazhdi, afër Strugës. Ditën e formimit kishte 3 batalione me 310 luftëtarë. Luftoi për çlirimin e mbrojtjen e Dibrës më 9 korrik, në rrugën Strugë-Dibër më 1-3 gusht, në mbrojtjen e Peshkopisë më 22 gusht, së bashku me Brigadën V Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë (UNÇSH), në luginën e lumit Treska më 29-31 gusht, te Prilepi nga mesi i shtatorit, në Sharr më 25-26 nëntor, në çlirimin e Tropojës më 16 tetor, të Junikut më 26 tetor, në çlirimin dhe mbrojtjen e Deçanit më 30 tetor, deri në mesin e nëntorit, në çlirimin e Pejës më 18 nëntor 1944 dhe të vise të tjera të Kosovës, kundër forcave nacionaliste në periudhën dhjetor 1944 - mars 1945.

Brigada II e Kosovës dhe e Metohisë u formua më 9 shtator 1944, në fshatin Lilanc të Bujanocit. Ditën e formimit Brigada kishte 4 batalione me rreth 600 luftëtarë. Mori pjesë në luftimet për Bujanocin më 8 nëntor, për Gjilanin më 16 nëntor dhe për Ferizajn më 17 nëntor. Në rajonin e Kaçanikut luftoi gjatë shkurtit e marsit të vitit 1945. Më 8 shkurt 1945, brigada u rreshtua në kuadër të Divizionit 52 të Kosovës. Me urdhër të komandës së këtij divizioni, ajo zhvilloi luftime në Prizren, Ferizaj, Kaçanik etj. kundër forcave nacionaliste shqiptare, në emër të spastrimit nga "reaksioni shqiptaromadh".

Brigada III e Kosovës dhe e Metohisë u themelua më 16 shtator 1944 në fshatin Krajmirovc të Vranjës dhe u shpërnda më 13 prill 1945. Me rastin e formimit kishte 3 batalione me rreth 450 luftëtarë. Operacionet kryesore i zhvilloi për çlirimin e Medvegjës, Podujevës dhe të Prishtinës gjatë nëntorit të vitit 1944. Në janar dhe prill të vitit 1945 luftoi kundër forcave nacionaliste në rajonin e Gjakovës dhe të Rahovecit, si dhe në Drenicë.

Brigada IV e Kosovës dhe e Metohisë u formua më 13 tetor 1944 në Krumë (Shqipëri) nga batalioni partizan "Kosova", nga luftëtarë të rinj dhe një numër udhëheqësish të Batalionit I të Kosovës. Ajo kishte 3 batalione me rreth 400 luftëtarë. Mori pjesë në çlirimin e Gjakovës prej 14 tetor deri më 8 nëntor dhe në çlirimin e Prizrenit së bashku me Brigadën V Sulmuese të UNÇSH-së më 18 nëntor 1944. Më pas mori

pjesë në luftime kundër forcave nacionaliste shqiptare në rrethinën e Pejës, në Gjilan, si dhe në Drenicë kundër forcave të Shaban Polluzhës. *Brigada V e Kosovës dhe e Metohisë* u themelua më 24 shtator 1944 në Tullar të Medvegjës. Me rastin e formimit kishte 2 batalione me rreth 300 luftëtarë, kurse më 1 tetor 1944, 3 batalione me 500 luftëtarë. Brigada mori pjesë në operacionet për çlirimin e Kosovës në nëntor të vitit 1944 dhe kundër forcave nacionaliste shqiptare, në janar-mars të vitit 1945.

Brigada VI e Kosovës dhe e Metohisë u formua më 16 dhjetor 1944 në Mitrovicë nga Aradhja e Ibrit dhe nga luftëtarë të rinj. Me rastin e formimit kishte 3 batalione me rreth 1,000 luftëtarë. Gjatë shkurtit dhe marsit 1945 luftoi kundër forcave nacionaliste shqiptare.

Brigada VII e Kosovës dhe e Metohisë u formua më 15 nëntor 1944 në Gjakovë. Brigada kishte 4 batalione me rreth 4,000 luftëtarë në fund të dhjetorit 1944, ndërsa në janar të vitit 1945 arriti në 7,500 sish, kështu që ajo ishte brigada më e madhe e UNÇ-së së Kosovës. Në janar të vitit 1945 brigada u urdhërua nga Shtabi Operativ i UNÇ-së të Kosovës të nisët për në Frontin e Sremit. Njësite të kësaj brigade morën pjesë në operacionet luftarake në Vojvodinë, Serbi, Bosnjë, Kroaci etj. kundër forcave gjermane dhe çetnike serbe, të cilat vazhduan deri në muajin qershor të vitit 1945. Në këto luftime ajo pati edhe humbje të konsiderueshme.

Brigada VIII e Kosovës dhe e Metohisë u formua më 20 dhjetor 1944 në Rakosh të Istogut nga luftëtarët e Istogut dhe nga luftëtarë të rinj. Ajo kishte 4 batalione me rreth 2,000 luftëtarë. Në janar të viti 1945, me urdhër të Shtabit Operativ të UNÇ-së të Kosovës u urdhërua të marshonte në veri të Jugosllavisë me 4,000 luftëtarë. Luftëtarët e saj u përballën me trupat gjermane në Frontin e Sremit dhe të Triestës, deri më 9 maj 1945, por edhe më pas me njësitet kuislinge. (Fehmi Rexhepi)

BRIGËT. Njëri ndër popujt më të vjetër dhe më të mëdhenj indoeuropianë në Ballkan. Jetonin në lindje të lumit Vardar, në zonën ndërmjet Ohrit dhe Pellagonisë. Mendohet se brigët u shpërngulën në Azi të Vogël gjatë migrimeve të fillimit të mijëvjeçarit I p.e.r. Herodoti i identifikon me frigasit, të cilët e ndërruan emrin pas migrimin, andaj supozohet se të dy emrat, brig dhe frig, janë variante të së njëjtës rrënjë. (Emine Kalaja-Hajdari)

BRISKU Bahri (1933-). Mbledhës dhe studiues i folklorit, publicist. Lindi në Ulqin. Mbaroi studimet e letërsisë botërore dhe jugosllave. Një kohë punoi si gazetar dhe korrespondent për gazetën “Rilindja” të Prishtinës. Ndërkohë kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës nga fusha e letërsisë popullore në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Punoi për shumë vjet si mësimdhënës në Mal të Zi dhe në Kosovë. Botoi një sërë artikujsh e studimesh nga fusha e folklorit, si dhe veprat: “Studime shqiptare”, “Lirika popullore në Ulqin-Shestan dhe Bregu i Bunës”, “Deti dhe detarët shqiptarë në letërsinë popullore”, “Këngë popullore të shqiptarëve në Mal të Zi” etj. Në vitin 1983 u dënua me shtatë vjet burg për shkaqe politike. Është bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Jeton në Ulqin. (Zymer U. Neziri)

BROÇIXhejlane (1943-1994). Mezzosoprano. Shquhej në zhanrin e muzikës popullore dhe qytetare me zërin e shkolluar (prof. Terpkov). Nga interpretimet më të bukura të saj mbetet “Zambaku i Prizrenit”, me të cilën është paraqitur në festivale, në turneun e Ansambilit “Shota” në Çekosllovakia (1964), Francë, Belgjikë, Zvicër (1965). U dallua për interpretim qysh si nxënëse e gjimnazit në Pejë, duke u vetëshoqëruar me kitarë. Më pas vazhdoi studimet në degën e edukatës muzikore në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Është paraqitur në “Akordet e Kosovës”, në Festivalin e Folklorit në Sarajevë etj. Në baletin “Kënga e Rexhës” të A. Kocit interpretoi këngën “Çohu more Rexho” edhe në bienalin e baletit në Lubjanë, ku u prezantua me Ansamblin e baletit të Kosovës. Ka punuar në redaksinë e programit për fëmijë në Televizionin e Prishtinës. Ishte soliste e Shoqërisë “Ramiz Sadiku” në Pejë, e Radio Prishtinës, e korit të Radio Prishtinës, anëtare e Korit “Collegium Cantorum” etj. (Besa Luzha)

BRODI. Fshat në komunën e Dragashit, 12 km në juglindje të qendrës. Shtrihet në luginën e vogël dhe të thellë malore, në lartësi mbidetare 1300 m. Përmendet si vendbanim në defterin e Sanxhakut të Prizrenit në vitin 1530. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 48.14 km², nga e cila pjesa më e madhe është e mbuluar me kulloza dhe pyje, kurse pjesa tjetër është nën ara dhe livadhe. Një numër i

konsiderueshëm i popullsisë së fshatit emigroi brenda dhe jashtë Kosovës. Valët intensive të emigrimit janë reflektuar në zvogëlimin e numrit të popullsisë dhe regresin e përgjithshëm demografik. Derisa në vitin 1948 Brodi kishte 2,248 banorë, në vitin 2011, në Brod u regjistruan 1,544 banorë. Në aspektin funksional, Brodi është qendër e pavarur rurale. Popullsia merret me blegtori, bletari, turizëm, mbledhjen e frutave malore, bimëve mjekuese etj. Një numër i banorëve ka mërguar në vende të ndryshme të Europës. Remitancat që i sjellin emigrantët janë një burim i rëndësishëm për zbutjen e varfërisë dhe ruajtjen e mirëqenies. Një pjesë e madhe e territorit ndodhet brenda kufijve të Parkut Kombëtar “Sharri”. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, shtëpinë e shëndetit, disa njësi tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

BROJ Valter (Walter Breu) (1949-). Gjuhëtar gjerman. U diplomua për filologji sllave, studime shqiptare, gjuhësi angleze dhe literaturë mesjetare në Universitetin e Munihut. Në vitin 1987 është habilituar në Munihi për zhvillimin e gjuhëve sllave. Punoi si profesor i gjuhësisë së aplikuar në Universitetin e Bajroit dhe më pas të Konstancës. Kontribuoi në programin e studimeve doktorale shqiptare në Universitetin e Kozencës në Itali. Puna shkencore e tij është përqendruar në fushën e gramatikës dhe të semantikës. Është marrë dhe me studimin e mënyrave të foljes në gjuhën shqipe: “Kategoria e mënyrës në shqipen dhe varietetet e saj” (Category of Mood in Albanian and Its Varieties). Botoi studime për sistemin foljore të arberishtes. (Ardita Berisha)

BROJA Mulla Iljas (1892-1946). Titullar i fesë islame. Lindi në fshatin Kastriot të Drenicës. Mësimet e para i mori në Medresenë e Vushtrrisë, ndërsa i vazhdoi në atë të Pejës. Më 1916 u emërua imam në Xhaminë e Brojës. Gjatë kohës së Mbretërisë Jugosllave u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Mori pjesë aktivisht në organizimin e mbrojtjes së territoreve shqiptare nga sulmet çetnike në Kollashin të Ibrit (1941) dhe më vonë në rezistencën e Drenicës (1944). Për shkak të aktivitetit dhe bindjeve politike, u burgos nga OZNA në shkurt të vitit 1946 në fshatin Leqinë, bashkë me mikun e tij, luftëtarin e njohur Ahmet Babajn nga Llausha. Pasi e

ekzekutuan të zotin e shtëpisë Sokol Imerin, ku ishin strehuar, I. Brojën dhe A. Babajn i dërguan në fshatin Zllakuqan të Klinës, ku i pushkatuan. (Qemjal Morina)

BROKERI. Person fizik apo juridik që ofron shërbimet e tij në procesin e shitblerjes në treg, për individë ose kompani të treta, i cili për shërbimet e kryera merr një kompensim. Komisioni zakonisht është në proporcion me vlerën monetare të transaksionit, por mund të jetë edhe shumë monetare nominale (shpesh e referuar si “pagesa minimale”), për rastet kur vlera e transaksionit të realizuar është shumë e ulët. Brokieri paraqitet në ato tregje apo industri ku kërkohen njohuri specifike për produktet apo shërbimet si p.sh. sektori bankar, sektori i sigurimeve etj., ku brokieri mund t’i ofrojë informata dhe këshilla të specializuara klientit të tij për veprimet që duhen ndërmarrë në mënyrë që të maksimizohet interesi i tij. Detyrimi për maksimizim të interesit të klientit është cilësia që e dallon brokerin nga agjenti, i cili zakonisht kontrahohet nga kompanitë përkatëse për të rritur realizimin e tyre. Në Kosovë koncepti i brokerit është relativisht i ri. Kjo vjen si pasojë e nivelit të ulët të zhvillimit në të cilën gjenden tregjet financiare kosovare (p.sh. mungesa e bursës). Aktualisht korniza ligjore në Kosovë mundëson licencimin e brokerëve të sigurimeve (si individë apo kompani) në bazë të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime. Aspekte të tjera të brokerimit pritet të paraqiten krahas përparimit zhvillimor të tregjeve financiare. (Gëzim Tosuni)

BROKIER Bertrandon (Bertrandon de la Broquière) (1400-1459). Udhëpërshkrues francez i shek. XV. Gjatë gjysmës së parë të shek. XV ndërmori një udhëtim për në Tokën e Shenjtë, me urdhër të dukës së Burgundisë, Karlit të Guximshëm. Gjatë udhëtimit të tij kishte për detyrë sekrete që ta regjistronte gjendjen e përgjithshme në Perandorinë Osmane. Duke u kthyer në atdhe, kishte kaluar edhe nëpër vende të Ballkanit, përkatësisht ishte ndalur edhe në Kosovë për t’i parë pasuritë e saj minerare. Në këtë kontekst përmendet sidomos qyteti i pasur i Novobërdës. Gjatë udhëtimit të tij, Brokieri ishte mirëpritur edhe nga despoti Gjuragj Brankoviq. Në udhëpërshkrimet e tij theksonte se ka ndeshur në më shumë mirëpritje nga osmanët sesa

nga bizantinët. Udhëtimin e tij e përshkroi në veprën “Udhëtime përtej deteve, gjatë viteve 1432 dhe 1433”. Po më këtë titull vepra u botua në vitin 1805. Në librin e tij ai shpali projektin për bashkimin e Anglisë, Francës dhe Gjermanisë kundër Perandorisë Osmane. Sipas tij, plani është i lehtë për t’u realizuar, por janë bizantinët e jo turqit ata që nuk u besojnë perëndimorëve, andaj mundësia për aleancë me bizantinët është vështirë e realizueshme. Shënimet e Brokier-it janë me rëndësi për ta njohur sistemin ushtarak, administratën si dhe armatimin osman të kohës. (Muhamet Mala)

BROVINA Ahmet (1950-). Mjek, internist, hematolog, profesor. Lindi në Brovinë të Gjakovës, shkollën fillore e kreu në Prizren dhe Gjilan, ku mbaroi edhe gjimnazin. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Shkupit (1975). Pas diplomimit u punësua për dy vjet në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas, më pas kaloi në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme në Prishtinë. Specializoi për mjekësi interne, më 1981 u emërua asistent i po kësaj lënde. Temën e doktoratës nga kjo fushë e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1986). Në vitet vijuese u zgjodh docent, profesor inordinar dhe në vitin 2000 mori titullin profesor ordinar. Pas luftës kreu disa funksione në klinikat dhe departamentet përkatëse të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Mori pjesë në shumë simpoziume, kongrese dhe seminare ndërkombëtare. Ka publikuar mbi 100 punime si autor dhe bashkautor, si dhe është bashkautor i tekstit universitar “Mjekësia interne me kujdes”. (Bedri Zahiti)

BROVINA Azem (1946-). Gazetar i sportit. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë, Fakultetin Filozofik, degën e gjeografisë, në Universitetin e Prishtinës. Punën si gazetar i sportit e filloi në Radio-Prishtinë që në vitin 1970, punoi deri në vitin 1990, kur punëtorët e Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP) u dëbuan me dhunë nga puna nga regjimi i Serbisë. Që nga paslufta dhe deri në vitin 2013, kur u pensionua, punoi në Radiotelevizionin e Kosovës. Pati mbi një mijë e



AZEM BROVINA

dyqind transmetime e komentime të ndeshjeve të futbollit të niveleve të ndryshme. Për Radio-Prishtinën komentoj shumë ngjarje sportive, nga vendi i ngjarjes apo nga studiot e RTP-së, përfshirë lojërat olimpike verore dhe dimërore, kampionatet botërore të futbollit, Lojërat e Mesdheut, “Universiadat”, kampionatet botërore dhe europiane të basketbollit, kampionatet europiane të boksit, kampionatet europiane dhe botërore të hendbollit etj. (Lulzim Shala)

BROVINA Flora (1949-). Poete, veprimtare për të drejtat e njeriut, politikane. Lindi në Skënderaj. Kreu shkollimin në Prishtinë, ndërsa studimet për mjekësi në Beograd dhe



FLORA BROVINA

Prishtinë. Specializimin në fushën e pediatriisë e kreu në Zagreb. Punoi si gazetare në të përditshmen “Rilindja”, ndërsa më pas iu kthye profesionit të mjekësisë. Në vitin 1992 themeloi Lidhjen e Gruas Shqiptare për të kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të gruas. Më 20 prill të vitit 1999 u rrëmbye në banesën e saj nga paramilitarët serbë dhe u dërgua në burgun e Pozharevcit në Serbi, ku më pas u dënua me 12 vjet burg. Pas presionit ndërkombëtar, u lirua dhe u kthye në Kosovë në vitin 2000. Që nga ajo kohë u angazhua në punë humanitare dhe në aktivitete politike. Botoi disa libra me poezi: “Verma emrin tim” (1973), “Bimë e zë” (1979), “Mat e çmat” (1995). Poezitë e saj janë përfshirë në antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është deputete e Kuvendit të Kosovës dhe kryetare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. (Sali Bashota)

BROVINA Qamil (1921-2002). Pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, i burgosur politik. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Shqipëri. Gjatë shkollimit në Shqipëri u përfshi në grupet e rinisë komuniste dhe mori pjesë në demonstratat kundër pushtetit të Ahmet Zogut dhe më pas kundër pushtimit fashist të Shqipërisë (1939). Pas kapitullimit të Jugosllavisë më 1941 kthehet në Gjakovë dhe i bashkohet Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Një kohë mban postin e komisarit të dhjetësheve sulmuese të Gjakovës. Në fund të tetorit të

vitit 1942 zgjidhet komisar politik i Aradhes partizane “Zenel Hajdini” dhe më pas i Aradhes partizane “Emin Duraku”. Ishte pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit. Me formimin e Brigadës VII të Kosovës dhe Metohisë në nëntor të vitit 1944, Q. Brovina u zgjodh komisar politik i saj. Kjo brigadë, pas çlirimit të Kosovës, vazhdoi operacionet luftarake deri në Frontin e Sremit. Gjatë viteve 1946-1948 studioi në Akademinë Ushtarake në Moskë, ku mori gradën e nënkolonelit. Më 1949 burgoset dhe dënohet me 16 vjet burg, 8 nga të cilat i vuajti në burgun e Goli Otokut. Pas daljes nga burgu punoi në Radio-Prishtinë (1957-1977). (Fehmi Rexhepi)

BRUCELOZA ANIMALE. Sëmundje infektive kronike e kafshëve shtëpiake, të kafshëve të egra dhe e njeriut (zoonozë). Sëmundja është e pranishme në Kosovë në dhen dhe në dhi. Shfaqet me ndryshime nekrotike në organet e sulmuara dhe dështime të kafshëve mbarse. Shkaktarë të sëmundjes janë bakteret nga gjinia *Brucella*, që përmban 6 specie: *B. melitensis*, *B. abortus*, *B. suis*, *B. ovis*, *B. neotoma* dhe *B. canis*. Infeksioni shkaktohet kryesisht në rrugë perorale me ushqim, koitale dhe perkutane me insekte. Sëmundja vështirë mjekohet. Profilaksia konsiston në largimin e mikrobartësve nga tufa, vaksinimin e viçave femra të moshës 3-6 muajsh me vaksinë B-19 dhe vaksinimin e qengjave e kecape të moshës 3-6 muajsh me vaksinë Rev.1. Kafshët e reja seksualisht të pazhvilluara janë rezistente ndaj sëmundjes, ndërsa të vjetrat, sidomos ato mbarse, janë shumë të prekshme. Në tufat e lopëve të infektuara ndonjëherë dështojnë 40-70% e tyre dhe dështimi shfaqet zakonisht në muajin e 5-6 të mbarshmërisë. Diagnostikimi i sëmundjes bëhet me metoda standarde laboratorike. Kërmat e kafshëve eliminohen me përpunim teknik, grososje në varreza për kafshë dhe djegie të tyre. Brucezoza në kafshë nuk mjekohet. (Xhevat Domi)

BRUCELOZA. Sëmundje ngjitëse, sistemike, që bartet te njeriu nga kafshët e infektuara. Infeksioni përçohet nga delet, gjedhet, dhitë, qentë dhe derrat. Shkaktohet nga *brucellat*, të cilat janë kokobacile gram negative dhe janë katër tipa serologjikë: *abortus*, *mellitensis*, *suis* dhe *capis*, të cilat dallojnë për nga morfologjia dhe nga struktura antigjenike dhe biokimike. *Brucellat* janë mjaft rezistuese në ambientin e

jashtëm. Pas periudhës së inkubacionit nga 7 ditë deri në 2 muaj (mesatarisht 2 javë), fillojnë simptomat e sëmundjes: temperaturë e lartë, plogështi e përgjithshme, djersitje, dhembje e nyjave dhe simptome të prekjes së të gjitha organeve. Në fazën e fundit të sëmundjes shkaktari i sëmundjes lokalizohet në një apo disa organe (mëlçi, gjëndra limfatike, palcë kockore, sy etj.). Sëmundja është e përhapur në tërë botën dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e blegtorisë dhe efikasitetin e masave parandaluese. Masat parandaluese konsistojnë në vaksinimin e kafshëve dhe edukimin e popullatës. Të dhënat shkencore për këtë sëmundje datojnë që nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Kosova është zonë endemike dhe sëmundja shfaqet në formë sporadike dhe në formë të epidemive familjare. Brenda periudhës pesëvjeçare 1999-2004 janë shënuar 434 raste të sëmundjes, kurse në periudhën 2010-2013 janë shënuar 282 raste. (Isme Humolli)

BRUÇI Mirlind (1968-). Inxhinier i makinërisë, profesor universiteti. Lindi në Isniq të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Deçan dhe studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, ku e mbrojti dhe tezën e doktoratës (2005). Si autor dhe bashkautor mori pjesë në disa simpoziume dhe konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i softuerit për enkriptimin dhe dekriptimin e të dhënave, GOV-DYN Code (2008) dhe X-Code (2009) për nevoja të stafit diplomatik të Republikës së Kosovës. Ushtrroi disa funksione në ekonomi dhe në arsim e shkencë, si anëtar bordesh, konsulent projektsh etj. Merret me fushën e projektimit të proceseve teknologjike dhe veglave të përpunimit me deformim si dhe me simulimin e proceseve prodhuese-CIM. (Hysni Osmani)

BRUÇI Rrustem (1958-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Isniq të komunës së Deçanit. Përfundoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1984). Në tetor të vitit 1988 filloi punën në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Deçan. Në tetor të vitit 1990 u emërua anëtar i grupit të juristëve që do të harmonizonin statutin e komunës së Deçanit me Kushtetutën e Kaçanikut.

Për shkak të situatës së rëndë në Kosovë, më 1994 emigroi në Gjermani. Në qershor të vitit 1998, me fillimin e luftës çlirimtare, u kthye në Kosovës dhe iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ra heroikisht më 6 korrik të vitit 1998 në betejën e Loxhës. Presidentja e Kosovës e dekoroi me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Shkodran Imeraj)

BRUTOPRODHIMI KOMBËTAR (GNP). Është vlera e gjithëmbarshme e produkteve dhe e shërbimeve të shtetasve rezidentë në Kosovë dhe të shtetasve të Kosovës në vendet e tjera, që dërgohet në vend brenda një viti. Sipas vlerësimeve, brutoprodhimi kombëtar i Kosovës, që njihet edhe si GNP, në vitin 2014 ka arritur në 5,6 miliardë. Ky tregues ekonomik shpreh potencialet e konsumit dhe të investimeve në një vend dhe në këtë aspekt Kosova karakterizohet me një brutoprodhim kombëtar më të madh sesa brutoprodhimi vendor për 5-10%, varësisht nga rrjedha e dërgesave të emigrantëve (remitancat), të investimeve të jashtme dhe të një diference pozitive midis investimeve që bëjnë rezidentët e Kosovës jashtë vendit dhe investimeve të jashtme në Kosovë. Ndonëse nuk shpreh nivelin e zhvillimit dhe të aktiviteteve ekonomike që krijojnë vlerë të re brenda vendit, ky tregues është i rëndësishëm, sepse pasqyron strukturën e kërkesës në treg dhe potencialet zhvillimore. (Muhamet Mustafa).

BUASEN Anri (Henri Boissin) (1908-1998). Studiuës frëng, gjuhëtar, profesor. Studioi në Institutin Nacional për Studim të Gjuhëve e të Civilizimeve Orientale (INALCO) në Paris dhe është diplomuar për anglishten, për gjuhët fino-ugrike e ballkanike, mes të cilave edhe për shqipen (1949). Ka qenë drejtues i departamentit të shqipes në INALCO-s në Paris deri më 1968 dhe konsiderohet themelues i studimeve albanistike në Francë. Mbrojti disertacionin "Dialekti gegë i folur në Arbanasi në Dalmaci" (Le dialecte gégué parlé à Arbanasi en Dalmatie). Ka pasur interesime për serbokroatishten, bullgarishten e vjetër dhe greqishten e re. Botoi "Gramatikë e shqipes moderne" (Grammaire de l'Albanais moderne, 1975). A. Buaseni botoi edhe artikuj për gjuhën e për letërsinë shqipe në periudhën 1950-1970 dhe ka marrë pjesë në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike në Tiranë (1962). (Bardh Rugova)

BUÇARELI (Bucciarelli) Argjipeshkëv Dario (1827-1878). Prift françeskan, ipeshkëv i Pultit, argjipeshkëv i Shkupit me seli në Prizren. Lindi në Castelplanio të Italisë. Në fillim shërbeu si prift i rendit françeskan, më pas si misionar në misionet shqiptare. Ishte sekretar i ipeshkëv të Shkodrës dhe pas kësaj u emëruar ipeshkëv i Pultit (1860). Në vitin 1864 u emërua argjipeshkëv i Shkupi në Prizren, ku shërbeu deri në vitin 1878. Në Prizren më 1870 ndërmoi nismën për ndërtimin e katedralës kushtuar Zojës Ndhimëtare, e cila u shugurua 100 vjet më vonë (1970). Gjatë kohës së shërbimit të tij si ipeshkëv u mbajt Koncili i Parë i Vatikanit, në të cilin ishte i ftuar edhe Bucciarelli. Ishte nënshkrues i dytë i postulatit për definimin e infalibilitetit të Papës. Mori pjesë në punimet e Kuvendit të Dytë të Arbërit në vitin 1871. Ka lënë në dorëshkrim dy raporte të rëndësishme të vitit 1865 dhe 1866-1868. Është autor i veprave “Gramatika e gjuhës shqipe” (Romë, 1862), “Udha e Krygjës (Romë, 1862) dhe “Doktrina e krishterë” (Romë, 1877). Vdiq në Prizren. (Gjon Berisha)

BUÇINCA Beqir (1942-). Trajner i hendbollit. Lindi në Godanc të komunës së Shtimes. Me lojën e hendbollit nisi të merret në vitin 1957/58, si nxënës i Normales së Prishtinës, përkatësisht si anëtar i klubit të hendbollit “Normalisti”. Pas përfundimit të normales, karrierën e vazhdoi në skuadrën e “Borcit” të Ferizajt, si lojtar e më vonë edhe si trajner. Në vitet 1972/73 drejtoi skuadrën e femrave dhe arriti të jetë dy herë kampion i Kosovës dhe dy herë f'i inkuadrojë në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë, ku bënë pjesë skuadrat nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Në vitin 1975 drejtoi ekipin e parë të “Borcit”, i cili bënte gara në ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Ka ushtruar edhe detyrën e përzgjedhësit të përfaqësueses së Kosovës në hendboll. U nderua me shumë çmime dhe mirënjohje. (Lulzim Shala)

BUÇINCA Fahri (1934-). Lindi në Vushtrri, ku kreu edhe shkollën fillore. Pas Shkollës Normale në Prishtinë, studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Fillimisht punoi si mësues në disa fshatra dhe në Vushtrri, pastaj drejtues i arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë dhe çështjeve sociale në Vushtrri e në Prishtinë. Dhjetë vjet ishte drejtor burgu i Qarkut të Mitrovicës dhe i

Shtëpisë ndëshkuese-korrektuese në Smrekonicë. F. Buçinca ishte nismëtar dhe themelues i institucioneve të ndryshme arsimore e kulturore, i klubeve sportive, organizator garash të ndryshme, veprimtar kundër analfabetizmit në Kosovë, për arsimimin dhe emancipimin e femrës etj. Me bashkëshorten e tij themeloi manifestimin Takimet e Poeteshave Mbarëshqiptare në Vushtrri, Fondacionin “Çifti Buçinca” për shkollimin e vajzave etj. U mor edhe me shkrime publicistike. Botoi veprat: “Mizoritë serbe në Vushtrri dhe rrethinë 1918-1956” (2009), “Cafu Beg Ulqini dhe veprimtaria politike e tij” (2009) etj. Për të arriturat në lëmin e arsimit, kulturës dhe sportit u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Afërdita Deva-Zuna)

BUÇINCA Naxhije (1935-). Mësuese veterane, veprimtare e emancipimit të femrës. Lindi në Ulqin, shkollën fillore e kreu në Tiranë, progjimmazin në Ulqin, shkollën normale në Prishtinë. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi si mësuese në shkollën fillore në Krajë, në Pistull (Ulqin), pastaj në Vushtrri. Në periudhën 1985-1991 ishte mësuese në shkollën fillore “Dardania” në Prishtinë. Kontribut të veçantë dha në arsimin dhe emancipimin e femrave në Kosovë. Është bashkëthemeluese e shoqatës “Grupi i krijueseve dhe veteraneve të arsimit” (1993), e Fondacionit për shkollimin e vajzave “Çifti Buçinca”, aktiviste në fushën e kulturës, përfshirë edhe Takimet e Poeteshave Mbarëshqiptare, që mbahen çdo vit në Vushtrri. U shqua edhe për aktivitetin e saj politik. Për punën e saj mori disa mirënjohje dhe dekorata. (Afërdita Deva-Zuna)

BUÇINCA Qemal (1941-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Vushtrri, shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë, ndërsa studimet e rregullta dhe pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Me punë profesionale nisi në minierën “Trepça” dhe në Fabrikën



QEMAL BUÇINCA

Kimike “Azotiku” në Obiliq. Më 1970 u zgjodh asistent, më pas ligjërues, docent dhe profesor i asociuar. Gjatë periudhës së angazhimit në procesin mësimor, botoi punime të ndryshme profesionale dhe shkencore. Në fushën e shkencave ekonomiko-organizative ka të botuara disa vepra: “Efikasiteti i punës së sistemeve organizative në kushte kalimtare” (2003), “Vjetrimi dhe përtëritja e diturisë në kushte kalimtare” (2003), “Organizimi dhe ekonomika e komunikacionit” (2003), “Menaxhimi i prodhimitarisë” (2008) etj. (Hysni Osmani)

BUDA Aleks (1910-1993). Historian, akademik. Lindi në Elbasan në një familje intelektuale hebreje. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Salzburg të Austrisë dhe studimet në



ALEKS BUDA

Universitetin e Vjenës (1929-35). Atje mori mësim nga profesorë të njohur Karl Patsch-i dhe Norbert Jokli. Pas studimeve, punoi si mësues në gjimnazin e Tiranës dhe më pas në Liceun e Korçës. Më 1941

shkoi në Universitetin e Padovës (Itali), për të specializuar në fushën e gjuhësisë dhe të ballkanistikës, pranë profesorit Karlo Tagliavini, por u kthye në atdhe për shkak të luftës. Aleks Buda mori pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare (1943-1944) dhe ishte nënkryetar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për Qarkun e Elbasanit, drejtor i Bibliotekës Kombëtare (1945-1946), njëri nga themeluesit e Institutit të Shkencave (1946). Ndiqmoi në krijimin e sektorëve të arkeologjisë, historisë së lashtë, historisë së mesjetës dhe të artit mesjetar, historisë së kohës së re e të etnologjisë. Ishte drejtor i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë dhe njëri ndër themeluesit e katedrës së historisë në Universitetin e Tiranës (1957).

Aleks Buda, ndonëse specializoi për letërsi, bëri karrierë si historian. U shqua sidomos në historinë e Mesjetës dhe të Rilindjes Kombëtare. Ishte bashkautor dhe redaktor përgjegjës i edicionit të parë “Historia e Shqipërisë” (vëll. I-II, 1959-1965), dha një ndihmesë për hartimin e Fjalorit enciklopedik shqiptar (1985) dhe përfaqësoi shkencën historike në konferencat e kongreset ndërkombëtare. Ishte kryetar i parë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nënkry-

etar i Shoqatës Ndërkombëtare të historianëve të Europës Juglindore, anëtar i Komitetit Drejtues të Shoqatës Botërore të Historianëve. Pati ndikim edhe në historiografinë e Kosovës qoftë përmes shkrimeve, qoftë përmes ligjeratave që mbajti në Universitetin e Prishtinës.

Aleksa Buda ka botuar një varg artikujsh studimorë në revistat brenda dhe jashtë vendit. Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka botuar kompletin e veprave të Aleks Budës “Studime historike” (2002). Një përzgjedhje studimesh u botua edhe nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (2006). Ishte laureat i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Kryetari i Republikës së Austrisë e dekoroi me “Medaljen e Madhe të Artë” (1990). (Ramiz Abdyli)

BUDAJ Arpad (Árpád Buday) (1879-1937). Arkeolog hungarez. Lindi në Marosgezse të Hungarisë, doktoroi në vitin 1906 dhe nga viti 1924 punoi në Universitetin Szeged, në Institutin Arkeologjik dhe ishte dekan i Fakultetit të Arteve (1931-1937). Gjatë qëndrimit në Kluj bëri vizita studimore në Vjenë, Gjermani, Itali dhe Shqipëri. Veprat e tij kryesore janë: “Mbishkrime romake” (1914), “Historia e lashtë” (1922) dhe “Problemi i kalorësit trak zot” I, II (1926-1928). Në ekspeditën përnjohëse në Rrafshin e Dukagjinit gjatë Luftës së Parë Botërore, duke qenë në shërbim të Austro-Hungarisë, evidentoi lokalitete e objekte arkeologjike, si Kastrumi i Pejës me planimetri, dy varre familjare të periudhës romake, tri pllaka varri prej mermeri me mbishkrime latine (shek. II-III p.e.r.). Duket se bëri kërkime edhe në Studenicë, Vrellë, Çerkolez, Zllakuçan, Klinë, Mitrovicë e Vushtrri. Ofroi dhe një hartë të vogël arkeologjike të Kosovës, të mbuluar nga austro-hungarezët, përderisa pjesa nën bullgarë i mbeti e paeksploruar, andaj interes të veçantë zgjon vepra “Kërkimet arkeologjike në Shqipëri II” (1918). (Arben Arifi)

BUDAKOVA Hasan Hysen (1860-1935). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në fshatin Budakovë të Suharekës. Si i ri mori pjesë në Luftën e Koshares (1881), kundër ushtrisë osmane, në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Luftoi përkrah Sefë Koshares. Në vitin 1899 mori pjesë në Lidhjen e Pejës, si delegat i krahinës së tij, ndërsa në kryengritjen e vitit 1910 luftoi përkrah me Idriz Seferin e Isa Boletinin, kur u bëri ballë forcave osmane

të Shefqet Pashës në malet e Budakovës. Gjithashtu ishte pjesë e Kuvendit të Junikut të vitit 1912. Në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912, me forcat kryengritëse shqiptare çlirroi Suharekën, Rahovecin dhe Prizrenin. Pas vitit 1912 luftoi kundër ushtrisë pushtuese serbe dhe më vonë kundër asaj bullgare. Bashkëpunoi me shumë udhëheqës të tjerë, si Sadik Ramë Gjurgjevikun dhe merr pjesë në Kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit të vitit 1919, si njëri nga udhëheqësit kryesor. Pas vitit 1920 gjithashtu u përfshi në kryengritjet kundër Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene dhe më pas asaj Jugosllave. Mori pjesë pothuajse në të gjitha ngjarjet e rëndësishme kombëtare, derisa vdiq në vitin 1935. (Naim Musliu)

BUDI Pjetër (1566-1622). Shkrimtar, prift katolik, ipeshkëv i Zadrimës. Lindi në Gur të Bardhë të Matit, ishte autodidakt. Mendohet se do të jetë regjistruar në Kolegjin Ilirik, por



PJETËR BUDI

nuk kishte shkuar atje. I ri kishte qëndruar pranë ipeshkvijve të vendit dhe kishte mësuar deri në moshën 21-vjeçare, kur ishte dorëzuar prift dhe kishte shërbyer si meshtar në Kosovë e në Maqedoni. Më 1599 u zgjodh zëvendës i përgjithshëm (Vicario generale) i Serbisë, ku qëndroi shtatëmbëdhjetë vjet. Në vitin 1616 shkoi në Romë, ku qëndroi deri më 1621. Më 1621 u emërua ipeshkëv i Zadrimës, ku qëndroi deri më 1622 (dhjetor), kur u mbyt derisa po kalonte Drinin. Ka pasur bindjen se kleri që shërbente ndër shqiptarë duhej ta dinte gjuhën e vendit, prandaj i kishte hyrë ndërmarrjes së largimit nga viset shqiptare të klerit që nuk fliste shqip dhe për këtë organizoi besëlidhje të priftërinjve dhe të popullit. Letra e Budit drejtuar kardinalit Gozzadino në Romë është skicë-projekt për kryengritje kundër Turqisë. Të botuara Pjetër Budi na ka lënë katër vepra: 1. “Doktrina e kërshenë (Dottrina christiana)”, hartuar nga jezuiti P. R. Bellarmino, përkthyer shqip nga Dom Pjetër Budi nga Guri i Bardhë, Romë, Bartolomeo Zanetti, 1618. Njihet një kopje e ruajtur në Bibliotekën e Vatikanit me shënimin: R. I. VI. 449. E zbuloi Mario Roques. Në faqet 1-4 ka: “Të rekomenduum nd’ uratë gjith atyne qi ta marrënë me e xgjedhunë”;

Fletët 175-228 përmbajnë vjersha shqip, 1964 vargje; Në fletën 229 recto: “Gjithatyne qi ta marrënë me e xgjedhunë”. Është ribotuar më 1636. Më 1664 në Romë ka dalë botimi i katërt. Në të janë vërejtur ndryshime të vogla. Teksti është shtypur me germa latine dhe tri germa të shtuara si te Buzuku, me karaktere romane ose italike. Blerina Suta (“Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)”, (Tiranë, 2016) ka zbuluar një kopje në Bibliotekën Angelica në Romë, O-10-37, që përmban një version të ri të fashikulit A në raport me botimin që njohim. 2. “Ritualin roman (Ritvale Romanvm)”, përkthyer nga P. Budi, Romë, Zanetti 1621. Në faqen 327 është Pashënia, ndërsa në faqet 353-4 është poezia “Laudans invocabo Dominum”. 3. Ngjitur me “Ritualin Roman” është një vepër me numërim të veçantë 1-16 f., pa frontespice, pa datë botimi, me titullin: “Kush thotë meshë këto kafshë i duhet me shërbyem”. Nuk ka emër botuesi as aprovim e imprimatur. 4. “Pasëqyra e t’rrëfyemit” e atit Emerio de Bonis me sã tjera kafshë shumë të frujtueshime të shpirtit, për ndimë të gjuhës arbëneshë, e aqë m̃a tepërë për t’atynet qi s’janë të zotë me ndëgjuom gjuhu n cë tjera letërash, nkthym gjuhe cë latine mbë gjuhu t’arbëneshë zotit Dom Pjetër Budit prej Guri cë Bardhë Upeshkëpi cë Zadrimës. Në Romë, B. Zanetti, M.DC.XXI. Vepra e Budit është studiuar nga S. Riza, E. Çabej, K. Ashta, G. Svane, R. Ismajli, Z. Neziri, B. Gjoka, A. Berisha etj. G. Svane ka bërë një botim të plotë me tejskrim dhe konkordanca (1985-86). R. Ismajli ka botuar poezitë e tij me studim, transkriptim e komente (1986, 2006). Tekstet themelore doktrinale e kishare të Budit janë përkthime. Në to ka shumë fragmente origjinale që nuk janë tek autorët burimorë, rreth 100 faqe parathënie, parathënie e letra baritore. Janë tekste që dalin jashtë caqeve të mirëfillta fetare: tregojnë rrugën e hartimit, ose të botimit të veprave, u drejtohen lexuesve shqiptarë, elitës intelektuale të kohës, me shpjegime të nevojshme për të kryer shërbimet fetare e për çështje të tjera. Manifestojnë veçori të ndryshme të tekstit letrar, nga shprehja e zgjedhur e figurshme e deri te llojet e stilet e ndryshme: përshkrimi letrar, teksti urdhërues, përshkrimi etnografik dhe përshkrimi si citat i gjendjes, i situatave, shpjegimet diskursive, polemika dhe diskutimi etj. Në disa fragmente ka elemente të prozës biografike. Stili i Budit është vetjak dhe

autentik. Pjetër Budi është autor i vjershave të shkruara shqip. Ndër vjershat e Budit një pjesë janë të atë Palit prej Hasi (mbase “Dita e gjyqit” dhe “Mbi vdekjen”), një pjesë të përkthyerë e të përshtatura nga Budi, e një pjesë të vetë Budit. Vjershat e Budit mund t’i ndajmë në vjersha mbi historinë biblike dhe në vjersha okazionale. Kanë zgjuar interesimin e studiuesve dhe kanë nxitur vlerësime të ndryshme: nga lavdatat e skajshme deri te mohimi i vlerës së tyre. 3200 vargjet e tij janë tetërrokësh, varg tipik popullor shqip. Leksiku i tij përfshin jo më shumë se 2, 500 fjalë. Përdorte një gjuhë letrare për masën e letërsisë që shkruante dhe për funksionet e saj. (Rexhep Ismajli)

BUDIMA Jeton (1968-). Regjisor, publicist. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për regji teatri dhe filmi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2010). Bëri regjinë e disa shfaqjeve teatrore: “Faust 3” (2001), “Anti-Dogma” (2006), “Moulin Rouge” (2006), “Vija e kuqe” (2009), “Nora” (2012) etj. Është regjisor i disa filmave të shkurtër dhe dokumentarë. Me filmin e shkurtër “Banka” (2008) mori pjesë në festivalin e filmit të shkurtër në Clermont-Ferrand (Francë, 2010) dhe në festivalin e filmit të shkurtër Libertas Fim Festival, Dubrovnik (Kroaci, 2011). Që nga viti 2002 botoi vështrime dhe kritika mbi teatrin dhe filmin në shtypin e vendit. Nga viti 2010 është anëtar i Federatës Europiane të Kritikëve të Filmit. (Visar Krusha)

BUDIMIR Milan (1891-1975). Filolog serb. U shkollua në Sarajevë, ndërsa studimet për filologji klasike i përfundoi në Universitetin e Vjenës. Nga 1938 deri 1962 ishte profesor i rregullt dhe shef i degës së filologjisë klasike në Universitetin e Beogradit. U mor me studime të filologjisë klasike, sidomos me greqishten e vjetër dhe letërsinë romake. Bashkë me Petar Skokun ishte themelues dhe redaktor i revistës ballkanike “Revue internationale des Études balkaniques” ndërmjet dy luftërave botërore. Ndër veprat për studimet ballkanistike përmenden “Grekët dhe pellazgët” (Grci i Pelasti, 1950), “Pelasto-Slavica” (1956), “Nga gurra e Ballkanit” (From the Balkan Sources, 1969) etj. Ishte anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë nga viti 1955. Njihet si një nga mbështetësit e hipotezës pellazgjike për prejardhjen e shqipes. (Kadire Binaj)

BUHOLC Oda (Oda Buchholz) (1940-2014). Gjuhëtare gjermane, përkthyes. Lindi në Dessau, Gjermani. Pas shkollimit të mesëm studioi në Shqipëri gjuhë dhe letërsi shqipe. U diploma



ODA BUHOLC

mua në Universitetin “Humboldt” të Berlinit në vitin 1964 në fushën e albanistikës dhe të gjuhës bullgare. Në vitin 1969 mbrojti temën e disertacionit me titull “Dyfishimi i kundrinës në gjuhën shqipe” (Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen), e cila u botua me 1977, vepër e parë që trajton strukturën e shqipes në këndvështrim gjenerativ. Gjatë viteve 1970-1989 punoi bashkë me Vilfrid Fiedlerin në Institutin Qendror të Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave në Republikën Demokratike të Gjermanisë në Berlin, e më vonë edhe drejtuese e grupit hulumtues për ballkanistikë, në kuadër të këtij Instituti. Prej vitit 1979 deri më 1989 punoi në Universitetin e Humboltit në Berlin, si mësimdhënëse për lëndët e fushës së albanologjisë, ndërsa prej vitit 1990 u angazhua si mësimdhënëse për albanologji dhe ballkanologji në “Freie Universität” në Berlin. U mor me përkthime shqip-gjermanisht. Vepra kryesore e saj është gramatika deskriptive e gjuhës shqipe në bashkëpunim me V. Fidlerin “Albanische Grammatik” (1987). Po bashkë me V. Fidlerin dhe G. Ulishin hartuan fjalorin shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip. Njihet për përkthimet e veprave të letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, ndër to “Gjenerali e ushtrisë së vdekur” i Kadaresë (1977, 1988), “Antologji e poezisë shqipe nga Kosova” (1979, 1988), romani i D. Agollit “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1993) etj. Studimet e saj në fushën e sintaksës kanë vlerë shkencore për albanistikën dhe ballkanistikën. (Milote Sadiku)

BUJA Agush (1962-). Veprimtar politik. Lindi në Bujan të Lipjanit. Kreu studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Si nxënës i shkollës së mesme ishte njëri ndër organizatorët dhe pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1981 në Lipjan. Që më 1986 aktivitetin politik e zhvilloi në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Aktivitetin politik e vazhdoi në Zvicër, në kuadër të LPRK-së. Në periudhën 1987-

1999 ishte anëtar i kryesisë dhe sekretar i kësaj organizate. Në vitin 1997 u angazhua në logjistikën e UÇK-së. Më pas, në vitet 1998-1999 ishte anëtar i kryesisë së Këshillit Qendror të Fondit “Vendlindja thërret”. Dha kontribut edhe si anëtar i grupit diplomatik në takimet e zhvilluara në Selinë e OKB-së në Gjenevë. (Ali Uka)

BUJA Ramë (1958-). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, politikan. Lindi në Bujan të Lipjanit. Kreu studimet



RAMË BUJA

për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Për shkak të veprimtarisë politike, në vitin 1984 u burgos dhe u dënua me gjashtë vjet heqje lirie. Pas lirimit nga burgu (1990) u angazhua në degën e Lipjanit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ndërsa më 1994 u zgjodh anëtar i kryesisë së kësaj partie. Më 1997 e ndërpreu aktivitetin e tij në LDK dhe doli në mbështetje të UÇK-së. U inkuadrua në radhët e UÇK-së më 16 qershor 1998 në Zonën Operative të Pashtrikut, për të marrë pastaj detyra me përgjegjësi: anëtarë i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, kryeshf i drejtorisë për marrëdhënie publike dhe administrim civil në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm dhe anëtar i Drejtorisë Politike. Ishte anëtarë i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Pas çlirimit të Kosovës u emërua ministër i Pushtetit Lokal në Qeverinë e Përkohshme, më pas deputet në Kuvendin e Kosovës (dy mandate) dhe ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë në periudhën 2011-2014. Ka botuar disa vepra nga fusha e politikës: “Konferenca e Rambujesë” (2004), “Kudri institucional, politik dhe juridik i zgjidhjes së krizës në ish-Jugosllavi” (2008) dhe “Kosova në krizën jugosllave” (2011). (Ali Uka, Ruzhdi Jashari)

BUJA Shukri (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Zonës Operative të Nerodimes. Lindi në fshatin Bujan të Lipjanit. Më 1984 u emërua anëtar i Komitetit Organizativ për Kosovë i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës



SHUKRI BUJA

(LPRK) dhe udhëheqës i njësitit gueril, që vëpronte në kuadër të LPRK-së. Në vitin 1989 u burgos dhe u dënua me 13 vjet heqje lirie. Pas daljes nga burgu më 1994 u angazhua në ngritjen e UÇK-së. Më 1996 u zgjodh anëtar i këshillit të përgjithshëm të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) dhe anëtar i redaksisë së gazetës “Zëri i Kosovës”. Në mars të vitit 1998 u përfshi në radhët e UÇK-së, me detyrën për organizimin e njësiteve guerile për komunat Shtime, Lipjan, Shtërpcë, Kaçanik dhe Ferizaj, si dhe koordinator i njësiteve të UÇK-së nga fshati Fushticë e Lipjanit e deri në Gllaboçicë. Në vitin 1998 u emërua komandant i Nënzonës Operative të Nerodimes dhe më pas komandant i kësaj zone. Mori pjesë në shumë beteja, si ajo për bllokimin e grykës së Carralevës, Reçakut (15 janar 1999), betejën e Jezercit (korrik 1998). Pas mbarimit të luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Në vitin 2000 u përfshi në Partinë Demokratike të Kosovës dhe u zgjodh anëtar i këshillit drejtues të saj. Më 2007 dhe 2009, në dy mandate, u zgjodh kryetar i komunës së Lipjanit. Nga viti 2016 është deputet në Kuvendin e Kosovës. (Ruzhdi Jashari)

BUJANOI. Qytet në Luginën e Preshevës, në afërsi të lumit Morava Jugore. Shtrihet në udhëkryqin e magjistrales, e cila kalon nëpër korridorin natyror meridional të Moravës dhe



BUJANOI

Vardarit me rrugët transversale Gjilan-Bujanoc nga ana perëndimore dhe rrugës që shpie në

drejtim të Pçinjës nga ana lindore. Bujanoci shtrihet në lartësi mbidetare 394 m. Sipas defterëve osmanë në vitin 1519, Bujanoci kishte 32 familje me rreth 180 banorë. Zhvillimin më të hovshëm e përjeton sidomos pas ndërtimit të rrugës Vranjë-Kumanovë (Xhadja e Vjetër) dhe të hekurudhës Beograd-Shkup, e ndërtuar në vitin 1888. Funkcionet e para të një qendre urbane dhe gravituese Bujanoci filloi t'i marrë sidomos pas vitit 1878, kur mori statusin e selisë brenda Kazasë së Preshevës. Përveçse si zonë bujqësore, në periudhën e mëvonshme Bujanoci merr rolin edhe të qendrës tregtare e zejtare. Lëvizja e numrit të popullsisë në Bujanoc tregon rritje të vazhdueshme, edhe pse shpërnguljet kanë qenë intensive. Derisa në vitin 1948 Bujanoci kishte 3,177 banorë, në vitin 2002 popullsia e Bujanocit arrin në 14,613 banorë rezidentë, ku shqiptarët përbënin 32% të popullsisë së qytetit. Përveç kultivimit dhe përpunimit të konopit, Bujanoci që herët bëhet i njohur edhe si qendër e grumbullimit dhe e përpunimit të duhanit. Gjatë disa dekadave të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar ky sektor zinte vend të rëndësishëm në ekonominë e rajonit. Bujanoci aktualisht paraqet një aglomeracion urbano-rural, ku përveç tij bëjnë pjesë edhe Rakoci, Bozhinjec, Levosova dhe Tërrnoci. Nga objektet e infrastrukturës shoqërore qyteti ka shtëpinë e shëndetit, administratën komunale, stacionin e veterinarisë, dy shkolla fillore, gjimnazin në gjuhën shqipe, pastaj shtëpinë e kulturës, bibliotekën, disa objekte sportive dhe Fakultetin Ekonomik dhe Juridik, i cili funksionon si degë e Universitetit të Novi-Sadit. Në Fakultetin Ekonomik zhvillohet mësimi në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. (Arsim Ejupi)

BUJANOCI (komuna). Komunë në Luginën e Preshevës, me sipërfaqe 461 km². Në veri dhe verilindje kufizohet me Vranjën, në lindje me komunën e Tërgovishtës, në jug me komunën e Preshevës, në veriperëndim me komunën e Kamenicës dhe komunën e Gjilanit. Kufiri juglindor i komunës paraqet njëherësh kufirin shtetëror me Republikën e Maqedonisë (komunën e Kumanovës). Nëpër territorin e komunës kalojnë rruga automobilistike ndërkombëtare Beograd-Nish-Shkup dhe rruga hekurudhore Beograd-Shkup-Selanik, si pjesë përbërëse të Korridorit X. Nëpër grykën e Konçulit kalon magjistralja rajonale Gjilan-

Bujanoc, që e lidh komunën e Bujanocit me Anamoravën dhe Kosovën. Pjesa më e madhe e territorit të komunës përbëhet nga relievi kodrionor-malor, i cili dominon sidomos në veri të komunës dhe në brigjet e majta të lumit Pçinja. Relievi rrafshor haset në luginat e lumenjve Moravica dhe Morava e Binçës, lumit të Tërrnocit etj. Në aspektin gjeotektonik ndodhet ndërmjet masivit të Rodopeve dhe Zonës së Vardarit. Në ndërtimin gjeologjik marrin pjesë rreshtet kristalore, granitet, shkëmbinjtë sedimentarë, por edhe ata me prejardhje vullkanike. Depozitimet aluviale janë të zhvilluara sidomos përgjatë Moravicës së Preshevës dhe Moravës së Binçës. Klima është e mesme kontinentale. Temperatura mesatare vjetore sillet rreth 10.6° C, me reshje mesatare 700 mm. Komuna e Bujanocit ka 43,302 banorë (2002) dhe 59 vendbanime. Sipas madhësisë demografike veçohen: Bujanoci, Tërrnoci, Bilaçi, Breznica dhe Konçuli. Sipas përkatësisë etnike, popullsia është e larmishme, me pjesëmarrje më të lartë të shqiptarëve dhe serbëve. Në pikëpamje të zhvillimit ekonomik, komuna e Bujanocit konsiderohet e prapambetur në raport me mesataren e Serbisë (të ardhurat kombëtare dhe punësimi sillen rreth 40-45% të kësaj mesatareje). Edhe pse me fond të pasur të tokave pjellore (26,656 ha), bujqësia vazhdon të jetë natyrale, autarkike dhe ekstensive. Komuna e Bujanocit, bashkë me komunën e Preshevës, kanë qenë rajone të njohura për traditën e mbjelljes dhe të kultivimit të duhanit. Komuna ka edhe disa objekte industriale me kapacitet të kufizuar, që kryesisht punojnë si reparte të fabrikave nga qendrat e tjera të Serbisë. (Arsim Ejupi)

BUJARI Alban (1970-). Fotoreporter. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Bën pjesë në brezin e ri të fotoreporterëve. Punën profesionale të fotoreporterit e nisi më 1997 në gazetën "Koha ditore". Nga ky vit, me fotoaparatin e tij regjistroi të gjitha zhvillimet e rëndësishme të kësaj periudhe, represionin serb, luftën e UÇK-së, krizën humanitare të refugjatëve, hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë etj. Fotografitë e tij u botuan në mediet më prestigjioze botërore: "Time", "Sunday Times", "The Independent", "The Guardian", "El Pais", "Suddeutsche Zeitung", "Kyoto News" etj. Ka punuar edhe për agjencinë europiane të shtypit, EPA, si përgjegjës për mbulimin

e kryengritjes së armatosur në Kosovë gjatë viteve 1998-99. Është redaktor i fotografisë në gazetën “Koha ditore”. (Zenun Çelaj)

BUJARI Fadil (1934-1990). Gazetar, përkthyes. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje. Për një kohë punoi mësues në Suharekë, pastaj ndoqi studimet në katedrën e albanologjisë të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit, ndërsa u diplomua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë kohës së studimeve në Beograd filloi punë në agjencinë e lajmeve të Jugosllavisë “Tanjug”. Më 1961 u kthye në Kosovë dhe filloi të punojë gazetar, më pas si redaktor i politikës së jashtme në gazetën “Rilindja”. Në vitin 1973 u zgjodh kryeredaktor i kësaj gazete, funksion që e ushtroi deri në vitin 1981. Pas këtij viti, deri në vitin 1990, punoi në rubrikën e fejtistikës. Për shumë vjet, krahas punës në “Rilindje”, ishte folës në Radio Prishtinë. Përktheu një sërë veprash letrare dhe studimore ngas gjuha serbokroate në gjuhën shqipe. (Zenun Çelaj)

BUJQËSIA NË MESJETË. Një nga degët bazë të ekonomisë në territorin Kosovës së sotme gjatë mesjetës. Ashtu si në gjithë trevat e tjera të Ballkanit Jugperëndimor, por me disa veçori të kushtëzuara nga pozita gjeografike, relievi, klima e rrethanat historike, Kosova kishte kushtet natyrore të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Qendrën e vendbanimit fshatar e përbënte vendbanimi i feudalit, që zakonisht ishte një kala e fortifikuar, e pajisur dhe me mjedise qëndrimi për të afërmit e feudalit, me magazina dhe me punishte të ndryshme. Kasollet e bujqve ndodheshin të shpërndara në territorin përreth kalasë së feudalit. Gjatë shek. XII-XIV prona feudale përfaqësohej nga institucionet fetare, veçanërisht nga manastiret, siç është fjala për Manastirin e Deçanit, Prizrenit, Banjskës, Graçanicës si dhe të disa fshatrave në pronësi të Manastirit të Hilandarit. Kulturat kryesore bujqësore ishin: gruri, thekra, elbi, tërshëra, orizi (në Osek, Skivjan, Kramovik të Gjakovës etj.), meli; nga perimet: qepa, grosha, hudhra, lakra, batha; nga bimët industriale: meli për prodhimin e birrës, lini, shafrani (në rrethinat e Pejës); pemët: arrat, gështenjat, qershitë, kumbullat, dardhat etj. Për ekspozimin dhe shitjen e tyre organizoheshin panairë të mëdha të njohura

edhe në qytetet mesjetare të Kosovës. (Gjon Berisha)

BUJQËSIA. Veprimtari ekonomike që ka si objektiv prodhimin e ushqimit të njerëzve, ushqim për blegtori, bimë industriale dhe biokarburante, si dhe të produkteve të tjera



PAMJE E NJË FERME NË KOSOVË

nëpërmjet kultivimit sistematik të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. Prodhimtaria bujqësore realizohet përmes bimëve (si aktivitet kryesor në bujqësi) dhe blegtorisë (si aktivitet i dytë për nga rëndësia brenda bujqësisë). Trajtimi i bujqësisë varet nga niveli i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik të një vendi. Produktet bujqësore përdoren si produkte të freskëta dhe si lëndë e parë për industrinë ushqimore dhe industrinë e tjera. Aktualisht, për shkak të rritjes së popullsisë në botë, rritjes së aftësisë blerëse dhe përdorimit të produkteve bujqësore edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë, në shumë vende bujqësia ka një rëndësi strategjike për të shtuar sasinë dhe llojet e ndryshme të produkteve bujqësore.

Në Kosovë bujqësia ka qenë për shumë kohë aktiviteti kryesor ekonomik, duke mbetur edhe tani i rëndësishëm (rreth 20% të brutoprodhimit vendor). Në zonat rurale, të cilat përfshijnë rreth 90% të territorit të Kosovës, jeton afër 60% e popullsisë. Për shkak të mungesës së një mbështetjeje të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse institucionale, si dhe të politikave liberale në importin e produkteve

bujqësore, të hyrat nga bujqësia në buxhetin familjar të familjeve në zonat rurale janë më pak se 10%. Ndër problemet që e karakterizojnë bujqësinë kosovare janë: pronat e vogla (më pak se 3 ha tokë bujqësore), parcializimi i madh i pronës, trashëgimia e pronave bujqësore, shndërrimi i pakontrolluar i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, lidhja e ulët me sektorin e përpunimit etj. Kosova ka rreth 600,000 ha tokë bujqësore, ose rreth 55% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Në kuadër të tokave bujqësore, rreth 400,000 ha janë tokë e punueshme dhe 200,000 ha kullota. Falë klimës së ndryshueshme, siç është ajo kontinentale në verilindje dhe submesdhetare në jugperëndim, në Kosovë janë krijuar rajonet prodhuese të kulturave të caktuara. Në Rrafshin e Dukagjinit më shumë janë të përqendruara kulturat, si hardhia e rrushi dhe perimet. Në Rrafshin e Kosovës, i cili përfshin mbi 55% të vendit, më shumë kultivohen drithërat, pemët dhe ka kushte për mbarështimin e blegtorisë. Zonat malore, të cilat kapin mbi gjysmën e territorit të vendit, kanë më shumë kushte për zhvillimin e blegtorisë dhe për kultivimin e frutave të malit dhe të bimëve mjekuese. Për shkak të mungesës së të reshurave gjatë vegetacionit, janë ndërtuar disa sisteme të ujitjes, që përfshijnë rreth 80,000 ha. Për shkak të amortizimit, shumica e sistemeve të ujitjes në Kosovë nuk janë plotësisht funksionale.

Në Kosovë veprojnë rreth 100,000 ferma bujqësore, nga të cilat rreth 85% u përkasin fermave vetëmbajtëse, që prodhojnë ushqim kryesisht për nevojat familjare. Pjesa tjetër u takon fermave gjysmëkomerciale dhe shumë më i vogël është numri i fermave të specializuara për prodhime për treg. Problemet kryesore, me të cilat sot ballafaqohen fermerët kosovarë janë të ardhurat e pamjaftueshme, si dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve, pastaj problemi i sigurimit të ushqimit të mjaftueshëm në treg, mungesa e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujit të pijshëm, të kanalizimeve etj. (Halim Gjergjizi)

BUJUPI Fatmir (1953-). Gazetar i sportit. Lindi në Dragobil të Malishevës. Kreu studimet për Makineri në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Karrierën e gazetarit profesionist e filloi në Radio-Prishtinë, së pari në redaksinë e sportit e pastaj si moderator i emisioneve informative. Më vonë, për një kohë punoi në Fabrikën e Tapicerive të Letrës ("Fazita") në Prishtinë. Edhe gjatë kësaj periudhe

bashkëpunoi me Radiotelevizionin e Prishtinës. Ishte njëri nga reporterët më të dalluar të sportit, sidomos të futbollit. Nga viti 2000 është gazetar i programit për Kosovën në gjuhën shqipe të Radios "Europa e Lirë" me seli në Pragë. (Gani Kosumi)

BUJUPI Rrustem (1951-). Grafist dhe piktor. Lindi në Istog. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, studimet për grafikë në Akademinë e Arteve në Prishtinë, ndërsa ato pasuniversitare në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1981). Grafikat e tij realizohen në shtypin e thellë, në teknikat e rezervës, por edhe në bakërshkrim dhe akuatintë. Trajton figurat nudo, natyrën e qetë dhe kompozicionet abstrakte. Më 2002 vazhdoi specializimin në Göteborg-Valand, Suedi. Është anëtar i SHAFK-ut nga viti 1977 dhe i shoqatës "Bohusgalleri" në Udevalla, Suedi. Organizoi ekspozita personale më 2013 në Udevalla "Folkets Hus", Suedi; më 2001 në Udevalla "Bohusgalleriet"; më 1991 në Udevalla "Galleri Leopol", pasta më herët më 1990 në Stenungsund "Galleri Koch" po në Suedi etj. Mori pjesë në ekspozitat e përbashkëta "Grafika e krijuesve kosovarë" në Prishtinë, Dubrovnik, Lubjanë, Zagreb, Londër, Kopenhagë, Malmö, Romë, Munihi, Palermo, Damask etj. Jeton e punon në Suedi. (Fatmir Krypa)

BUKOSHI Bujar (1947-). Mjek, urolog, profesor i universitetit, ish-kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Lindi në Therandë. Kreu arsimin fillor në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Prizren. Mbaroi Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1971). Pas diplomimit punoi në Drenas, ndërsa pas specializimit në Beograd, punoi në repartin e urologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Më 1980-1981



BUJAR BUKOSHI

ishte në përsosje profesionale në Klinikën Urologjike Kemperhof në Koblenz të Gjermanisë, kurse në periudhën 1984-1985 qëndroi në Klinikën Urologjike të Universitetit të Lirë të Berlinit Perëndimor, ku merrej kryesisht me problematikën e onkologjisë urologjike dhe të transplantimit të veshkave. Mbrojti tezën e doktoratës në vitin 1985, në Fakultetin e Mjekësisë në Berlin. Në vitin 1979 u zgjodh asistent,

ndërsa më 1985 docent në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Mori pjesë në shumë tubime profesionale ndërkombëtare deri në vitin 1990, kur për shkaqe politike u largua nga puna. Ishte pjesëmarrës aktiv i lëvizjes politike për pavarësinë e Kosovës. Ishte njëri ndër nismëtarët e themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në periudhën 1991-1999 ishte kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës në mërgim. Pas luftës ishte deputet i Kuvendit të Kosovës dhe ministër i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës. (Avdyl Krasniqi)

BUKUROCA. Vendbanim rural i tipit të dendur, 10 km në verilindje të Preshevës. Shtrihet në rrafshin aluvial të Moravicës, në anën e djathtë të këtij lumi, në lartësi mbidetare 430 m, ndërmjet magjistrales automobilistike ndërkombëtare E-75 dhe rrugës hekurudhore Beograd-Shkup-Selanik. Afër fshatit janë zbuluar gjetje të ndryshme arkeologjike, që dëshmojnë për popullimin e hershëm të kësaj zone. Numri i banorëve të fshatit Bukuroc brenda periudhës 1948-2002 dyfishohet, nga 457 banorë (1948), në 1,062 banorë (2002). Tokat pjellore në rrafshin aluvial të Moravicës kanë mundësuar zhvillimin e perimtarisë, ndërsa sipërfaqet e livadheve në rritjen dhe kultivimin e bagëtisë. Në fshat punon një fabrikë e qumështit, e cila siguron lëndën e parë nga fshati dhe vendbanimet përreth. Edhe nga ky fshat një pjesë e popullsisë ndodhet me punë të përkohshme në botën e jashtme. (Arsim Ejupi)

BULAJIQ Dushan (Dušan Bulajić) (1929-1992). Mjek, kirurg, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për mjekësi në Universitetin e Beogradit. Pas diplomimit (1960) punoi në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës. Kreu specializimin për kirurgji të përgjithshme në Beograd, kurse disertacionin e mbrojti në Prishtinë më 1977. Më 1971 u zgjodh asistent i lëndës së kirurgjisë së përgjithshme për mësim në gjuhën serbe në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më pas u emërua docent, profesor inordinar dhe më 1989 profesor i rregullt. Ishte për shumë vjet shef i repartit të kirurgjisë abdominale. Në vitin 1990, kur regjimi serb futi masat e dhunshme në Qendrën Klinike Universitare dhe në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, D. Bulajiq ishte drejtor i Klinikës së kirurgjisë dhe deputet në Parlamentin e Serbisë.

Gjatë mandatit të tij u përjashtuan nga puna shumica e kirurgëve shqiptarë. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve profesionale dhe shkencore. (Avdyl Krasniqi)

BULATOVIQ Zharko (Žarko Bulatović) (1935-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Cerovicë (Kollashin, Mali i Zi). Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkupit. Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit kreu studimet e magjistraturës, ndërkaq doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Lubjanës. Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës u gradua në të gjithë titujt universitarë për lëndën e drejta penale. Ishte sekretar i Komitetit Universitar të Lidhjes Komuniste, deputet i Dhomës Krahinore të Kuvendit të KSA të Kosovës dhe bartës i funksioneve të tjera në institucionet arsimore dhe politike të Kosovës dhe të Serbisë. (Osman Ismaili)

BULJA Mehmed (1935-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universitar. Lindi në Mitrovicë, tetëvjeçaren e kreu në vendlindje, shkollën e mesme teknike në Kostollc, Serbi. Studimet themelore të elektroteknikës, studimet pasuniversitare dhe ato të doktoratës i kreu në Fakultetin Elektroteknik (FE) të Universitetit të Zagrebit (1977). Punoi në ndërmarrjen “Trepça” në Zveçan (1951- 1955) dhe më pas kaloi me punë në kombinatin “Kosova” në Obiliq, në ndërtimin e Termocentralit “Kosova A”. Në periudhën 1966-1970 ishte drejtor teknik në repartin për prodhimin dhe distribucionin e energjisë elektrike “Elektrokosmet” në Mitrovicë. Ndërkohë, u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1970) dhe në vitet vijuese merr titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar (1984) për lëndën elektranat dhe stabilimentet degëzuese. Është autor i disa punimeve profesionale dhe shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit nga lëmi i ferorezonancës. (Ali Gashi).

BULLGARISHTJA. Gjuhë e popullit bullgar, shkrirje popullatash turko-turane me sllave e me vllah. U takon gjuhëve indoeuropiane dhe grupit jugor të gjuhëve sllave. Gjuha më e hershme e dokumentuar sllave, e cila ndihmon zbulimin e dukurive të shumta dhe zhvillimin e të gjithave gjuhëve sllave. Ka pasur dy alfabete: glagolik dhe cirilik. Nga Mesjeta përdoret vetëm ciriliku. Ka tri periudha kryesore në

zhvillimin e saj: bullgarishtja e vjetër (shek. IX-XI), bullgarishtja e mesme (shek. XII-XIV) dhe bullgarishtja e re (shek. XV-). Shkruhet që nga shekulli IX dhe njihet si bullgarishte e vjetër ose sllavishte e vjetër. Pas çlirimit të Bullgarisë nga Perandoria Osmane, më 1878, u vendos që gjuha letrare bullgare të bazohet mbi të folmet lindore bullgare. Reformat e fundit më me rëndësi u zhvilluan në vitet e para të regjimit komunist, kur u thjeshtëzua drejtshkrimi. Në zhvillimin e saj historik, për shkak të kontakteve me gjuhët e tjera ballkanike, gjuha bullgare ka ndryshuar shumë në krahasim me gjuhët e tjera sllave. Ndryshe nga gjuhët e tjera sllave, bullgarishtja, sikur edhe maqedonishtja, shquhet për tiparet ballkanike: prapavendosja e nyjës, përsëritja e kundrinës, rrafshimi i formave të gjinore dhe dhanores, zëvendësimi i paskajores me lidhore, futuri me *do*, zanorja qendrore ë dhe ruajtja e kohëve të grupeve kryesore-grupi lindor dhe grupi perëndimor sipas kufirit fonetik të fonemës **ъ** (ja në lindje dhe e në perëndim). (Anton Pançev)

BULLGARIZMAT. Fjalë ose shprehje karakteristike vetëm për gjuhën bullgare, e huazuar në ndonjë gjuhë tjetër, përfshirë shqipen. Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-bullgare kanë qenë objekt hulumtimi nga ana e sllavistëve dhe e albanologëve. Elementet sllave (përkatesisht bullgare) janë hulumtuar në mënyrë të thellë dhe të rëndësishme nga studiues joshqiptarë F. Mikloshić, A. Selishçev, G. Majer, N. Jokl, P. Skok, H. Bariq, St. Mladenov, A. Desnickaja, nga studiues shqiptarë si E. Çabej, I. Ajeti, Xh. Ylli, J. Gjinari, R. Ismajli etj. dhe nga studiues bullgarë, si S. Mladenov, I. Duridanov, P. Asenova etj. Në shumë raste ndër sllavizmat jugorë të shqipes është e vështirë të dallohen huazimet bullgare nga ato të serbishtes. Të tilla janë: *gjobë, grusht, gozhdë, kyç, koritë, kosh, lakmi, lopatë, nevojë, padis, pijanec rob, trup, zakon*, por ka të tjera si *opingë, mezhdë, pijanec* që mbajnë vulë të qartë të bullgarishtes. Të tilla ka kryesisht në të folmet jugore të shqipes. (Anton Pançev)

BULLIQI Lirije (1955-). Skulptore. Lindi në Pejë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje, Fakultetin e Arteve Figurative, degën e skulpturës, në Prishtinë (1990). Në Galerinë Kombëtare të Kosovës punon nga themelimi (1980). Mori pjesë në ekspozita

kombëtare e ndërkombëtare: në Sallonin e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (1983-2000), në ekspozitën e dizajnit kosovar në Galerinë e Arteve të Kosovës (2004), në ekspozitën ndërkombëtare “Kupat e trofeve” në Galerinë e Arteve të Kosovës, pastaj në Rijekë, Çakovec, Rab, Ozalj të Kroacisë, në ekspozitën “Femrat krijuese” në Muzeun e Kosovës (2005) në Bienalen e dizajnit në Galerinë e Arteve të Kosovës (2006) etj. Mori mirënjohje në ekspozitën ndërkombëtare të qeramikës në Zagreb dhe në ekspozitën e qeramikës në Sallonin e Nëntorit “Dita e Flamurit” në Prishtinë. Punon kryesisht me qeramikë. (Luan Mulliqi)

BULLIQI Muharrem (1943-). Gazetar i sportit. Lindi në fshatin Llugë të Podujevës. Që në shollë të mesme filloi të merret me gazetari. Gjatë gjithë karrierës së tij prej gazetari punoi në gazetën e përditshme “Rilindja”, ku ndoqi ngjarjet sportive, kryesisht ato të atletikës, të basketbollit dhe të boksit. Ishte i pranishëm në shumë gara vendore e ndërkombëtare. Ishte zëvendëskryeredaktor i gazetës “Kosova sport”. (Baki Berisha)

BUNJAKU Abdyl (1935-1992). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Novosellë të Begut të komunës së Vushtrrisë. Kreu shkollën fillore në Vushtrri, Shkollën Normale në Prishtinë, ku edhe studioi pedagogjinë. Punoi si mësues dhe më pas shumë vjet ishte gazetar, redaktor e kryeredaktor në gazetën “Zëri i rinisë” e “Gazeta e pionierëve”. Ishte kryeredaktor shumëvjeçar i revistës humoristike “Thumbi”. Shkroi shkrime publicistike dhe letrare (prozë për fëmijë e të rritur, pjesë teatrale etj.). Veçohet për shkrimin e pjesëve teatrale për fëmijë në kohën kur ato i mungonin dukshëm letërsisë sonë. Gjithashtu dha ndihmesë për kultivimin e humorit në letërsinë për fëmijë dhe të rritur. Veprat e botuara: “Djaloshi pas plepit” (1976), “Kërrici i pikëlluar” (1977), “Ndarja e roleve” (1979), “Thyerja” (1980), “Një njeri në tren” (1981), “Çapkenët” (1983), “Në anët tjetër të diellit” (1983), “Shkronjat në mur” (1989). (Xhevat Sylja)

BUNJAKU Avdyl (1947-). Inxhinier i makinërisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, Fakultetin e Makinerisë e kreu në Mostar. Studimet pasuniversitare i kreu në



AVDYL BUNJAKU

Zagreb, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1987). Pas diplomimit u punësua në Fabrikën “Metaliku” të Gjakovës, pastaj punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Teknike të Gjakovës deri në vitin 1974, kur u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të UP-së. Në Fakultetin Teknik ligjëroi lëndë të ndryshme në seksionin e makinerisë, dega e prodhimitarisë. Mbajti ligjërata edhe në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë, në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Komputerike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë. Në Fakultetin e Makinerisë dhe në UP kreu detyra të ndryshme udhëheqëse. Gjatë procesit të mësimdhënies hartoi disa dispensa për nevoja të studentëve dhe përktheu tri tekste universitare. Është autor dhe bashkautor i disa punimeve shkencore dhe mori pjesë në simpoziume dhe konferenca, brenda dhe jashtë vendit. Për nevoja të ekonomisë ka bërë disa projekte, analiza profesionale për makina të ndryshme dhe për instalime etj. (Hysni Osmani)

BUNJAKU Hasan (1944-). Gazetar. Lindi në Desivojcë të Kamenicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren dhe më pas studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Deri në vitin 1974 punoi në arsim dhe më pas gazetar në Radio-Gjilan. Nga nëntori i vitit 1974 e deri në mbyllje të gazetës “Rilindja” ishte korrespondent i përhershëm nga Gjilani. Në vitin 1999 themeloi radion “Megavox”, ndërsa nga fillimi i vitit 1991 ishte drejtues i sektorit të kulturës në administratën komunale të Gjilanit. Është autor i një sërë artikujsh, recensionesh e kritikash letrare e teatrore, themelues i manifestimit letrar “Takimet e vendlindjes”, të manifestimit kulturor “Flaka e Janarit” dhe i një sërë aktiviteteve kulturore në komunën e Gjilanit. (Shefqet Rexhepi)

BUNJAKU Jakup (1936-). Gazetar. Lindi në Poliqë të Kamenicës. Shkollë fillore e kreu në

vendlindje dhe në Hogosht, ndërsa Shkollën Normale në Prishtinë. Studimet për gjuhë e letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës. Ndoqi kursin profesional në Institutin Jugosllav të Gazetarisë në Beograd. Më 1959 u bë mësues në Pozharan të Vitisë, më pas në Ferizaj dhe Prishtinë, ndërsa nga viti 1965 tri vjet ishte korrespondent i “Rilindjes” nga Ferizaj. Më 1968 filloi punë në redaksinë e kësaj gazete, ku mbajti rubrikën e kryeqytetit dhe më vonë atë të infrastrukturës. Një kohë udhëhoqi shërbimin e dokumentacionit të gazetës, ndërsa drejtoi edhe kurset për gazetarët e rinj. Gjatë viteve 1995-1997 u mor me përpunimin e informatave që përfshiheshin në buletin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë. (Zenun Çelaj)

BUNJAKU Januz (1953-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë dhe të



JANUZ BUNJAKU

Anijendërtimit të Universitetit të Zagrebit (1976). Studimet pauniversitare i përfundoi po në Universitetin e Zagrebit (1980). Punoi në organizatën punuese “Metaliku” të Gjakovës. Më 1981 u zgjodh asistent në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe më pas u avancuan në titujt përkatës universitarë. Ishte titullar i disa lëndëve bazë: mekanika e fluideve, hidraulika e aplikuar, modelimi i rrymimit të fluideve, analiza hidraulike e rrjeteve termike etj. Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës (1999). Si bashkautor botoi tekstin universitar “Përmbledhje detyrash nga mekanika e fluideve” (1999) dhe hartoi dispensa. Ishte pjesëmarrës në disa konferenca shkencore në vend e jashtë. Në vitin 2015 u zgjodh prorektor i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë. (Xhemajl Fejzullahu)

BUQAJ Sheqerie (1977-). Aktore. Lindi në Lladroc të Malishevës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen në Malishevë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2000). Interpretoi një sërë rolesh në Teatrin Kombëtar të Kosovës,



SHEQERIE BUQAJ

në Teatrin “Dodona” etj. Krijoi një gamë të gjerë karakteresh, të trajtuar me ekspresion dhe ndjeshmëri. Ndër të tjera interpretoi në shfaqjet: “Shfaqja e fundit”, “Valja e djajve”, “Mbreti Lir”, “Mosmarrëveshja”, “Orestia”, “Zëri njerëzor”, “Motra e katërt”, “Shtëpia në ankand”, “Fedra”, “Dashnori i nënës sime”, “Trojanët”, “Kohë pa ngjarje” etj. Fitoi çmime për aktrim në shfaqjet “Udhësi i majës së lartë” në Festivalin “Talia e Flakës” në Gjilan dhe çmimin për aktoren më të mirë në Festivalin e Monodramës në Prishtinë për rolin në monodramën “Shumë urime për ty”. Luajti edhe në filmat artistikë “Etjet e Kosovës”, “Lufta mbaroi” dhe në Teatrin “Dodona” në shfaqjet për fëmijë: “Zobeida”, “Borëbadha”, “Konkursi”, “Përralla me lara”, “Po”. Është aktore rezidente e Teatrit Kombëtar të Kosovës. (Emin Emimi)

BURGU I GOLI OTOKUT. Burgu më famëkeq në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, në të cilin vuajtën dënimet edhe shumë shqiptarë. Burgu gjendej në ishullin e izoluar Goli Otok të



PAMJE E BURGUT TË GOLI OTOKUT

Dalmacisë. Ishulli është i gjerë afër dy kilometra dhe po aq i gjatë. Goli Otoku ishte burg i sigurisë së lartë. U themelua në vitin 1949, me vendim të posaçëm të strukturave partiake dhe shtetërore të ish-Jugosllavisë. Njihej me shenjën “shumë konfidencial” dhe shumë njerëz në Jugosllavi nuk dinin për ekzistencën e tij. Ishte një kamp pune i rëndë për të burgosurit dhe në gjithë ujdhesën gjendeshin bunkerë betoni. Ishulli tjetër afër tij, i quajtur

Sveti, ishte kamp pune për femrat e burgosura. Burgu u shfrytëzua për kundërshtarët e regjimit komunist në ish-Jugosllavi, veçmas për informbyroistë dhe të burgosur shqiptarë. Të burgosurit shfrytëzoheshin për punë të rënda e të detyrueshme në punishte guri, qeramike, metali etj. Aty vdiqën ose vuajtën dënimin shumë atdhetarë, patriotë, komunistë shqiptarë dhe të tjerë, të akuzuar si armiq të popullit. Në Goli Otok vuajtën dënimin 32,000 persona nga të gjitha viset e Jugosllavisë, nga të cilët humbën jetën 413 të burgosur (vrasje, vetëvrasje, vdekje natyrore etj.). Prej viti 1949 deri në vitin 1956 u përdor edhe për të burgosur të tjerë politikë. U mbyll në vitin 1988, ndërkaq u braktis tërësisht në vitin 1989, kur u shpall zonë muzeore për vizitorë. (Sulltane Ukaj)

BURGJET. Institucion korrektues i zbatimit të dënimeve penale. Në periudhën e autonomisë burgjet e Kosovës funksiononin të mbështetur në legjislacionin e atëhershëm në fuqi, në kuadër sistemit jugosllav. Shërbimi i pavarur korrektues i Kosovës së pasluftës u themelua më 5 nëntor 1999, me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Ky shërbim synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit, duke respektuar të drejtat e tyre themelore, pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religionin, si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. Shërbimi Korrektues i Kosovës është përgjegjës për administrimin e të burgosurve, të paraburgosurve, të të dënuarve, të të dënuarve të mitur në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës si dhe konventave europiane. Shërbimi qeveris me këto institucione: Burgun e Sigurisë së Lartë, Qendrën Korrektuese të Dubravës, Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Shërbimi, në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, mundëson shkollimin fillor dhe të mesëm për të gjithë të burgosurit e mitur, pa ndërprerje. Numri i të burgosurve dhe të paraburgosurve në Kosovë ndryshon dhe ai sillet nga 1,700 deri në 1,900 persona. (Osman Ismaili)

BURIMET E SHKRUARA ANTIKE. Burime të shkruara nga autorët grekë dhe romakë të

periudhës antike. Shërbejnë për ndërtimin e historisë së përgjithshme antike të popujve dhe të fiseve të Europës. Burimet e shkruara trajtojnë tematika të llojllojshme, duke filluar nga ato të karakterit historik-politik dhe ofrojnë edhe të dhëna gjeografike, etnografike, ekonomike, juridike, fetare etj. Numri i autorëve antikë, me vepra në gjuhën greke dhe latine është relativisht i madh dhe atyre u paraprin Homeri, burimi më i hershëm i shkruar në Europë. Vend të rëndësishëm në burimet antike kanë zënë edhe dardanët, të cilët përmenden në kontekste të ndryshme, varësisht nga ngjarjet dhe përfshirja e tyre në ato ngjarje. Këto burime ofrojnë një sërë të dhënash për pozitën gjeografike, zhvillimet politik-shoqërore dhe ekonomike të dardanëve dhe të Dardanisë. Ato janë bazë e rëndësishme edhe për rikonstruktimin e historisë së ilirëve në përgjithësi. (Emine Kalaja-Hajdari)

BURIMI I BAICËS. Burim i tipit karstik i ujërave termale nëntokësore në fshatin Baicë, në rrëzë të shpateve lindore të maleve të Berishës, në lartësi mbidetare 660 m, afër 6 km në jug të Komoranit (Drenicë). Burimi paraqitet në një thyerje tektonike në gëlqerorët zoogjen-riforë të kretakut, në kontakt me një thjerrëz të serpentiniteve, tektonikisht të mbivendosur mbi gëlqerorë, ndërsa në lindje gëlqerorët dhe serpentinitet kontaktojnë dhe mbulohen nga depozitimet deluviale dhe sedimentet e pliocenit. Prurja e ujit është afër 1.0 lit/sek, ndërsa temperatura 21°C. Për nga përbërja kimike uji i burimit i përket tipit hidrokarbonat të Ca-Mg, me mineralizim 0.561 g/l, me gaz të dioksidit të karbonit dhe të azotit dhe me elementet specifike të radiumit dhe stronciumit. Në burim është i improvizuar një vendgrumbullim i ujit. Mendohet se uji ka veti shëruese, edhe pse nuk janë kryer hulumtime balneologjike. Nga popullsia përdoret për shërimin e sëmundjeve të lukthit dhe të lëkurës. Burimi termal i Baicës është i veçantë. Në largësi disa cm nga uji termal buron më pak edhe ujë i ftohtë, me prejardhje nga infiltrimi i të reshurave. Uji i nxehtë vjen nga pjesa e gëlqerorëve karstikë të fundosur dhe të mbuluar nga sedimentet e pliocenit, ndërsa uji i ftohtë nga të njëjtit gëlqerorë në sipërfaqe. Burimi i Baicës, si hidromonument i veçantë, është vënë nën mbrojtje. (Vahdet Pruthi)

BURIMI. Shih: ISTOGU.

BURSA. Është një treg i organizuar, ku tregtohen letrat me vlerë që janë të tregtueshme, pastaj mallrat, valutat e huaja dhe kontratat e tjera. Bursat sjellin së bashku agjentët dhe tregtarët, të cilët kanë për t'i blerë ose për t'i shitur këto instrumente. Sipas instrumenteve që shiten, bursat mund të ndahen në nënkategori të ndryshme, si bursat e aksioneve ose të letrave me vlerë, pastaj bursat e mallrave dhe bursat e valutave të huaja. Në Kosovë, tregu i kapitalit është në një fazë të hershme të zhvillimit dhe rrjedhimisht ende nuk ekziston një treg kapitali i organizuar në formë të bursës. (Sokol Havolli)

BURSAT DHE KREDITË. Forma themelore për forcimin e bazës materiale të nxënësve dhe studentëve për mësim dhe studim më të suksesshëm. Kreditë u ndaheshin, zakonisht, studentëve të rregullt për përmirësimin e kushteve të studimit, ose për qëllime të veçanta (kadrovike, për studentë të talentuar etj.). Bursat dhe kreditë që i ndanin komunat, organizatat punuese etj., u ndaheshin nxënësve dhe studentëve sipas ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore, ku saktësoheshin kushtet për bursë apo kredi. Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, numri i nxënësve dhe i studentëve në Kosovë, të cilët merrnin bursa ose kredi, ishte i pamjaftueshëm. Në vitin shkollor 1985/86 në Kosovë u ndanë rreth 4,500 kredi dhe bursa. Praktika e ndarjes së bursave, kryesisht për studentë, vazhdoi edhe në Republikën e Kosovës, si nga institucionet vendore, ashtu edhe nga ato ndërkombëtare (qeveritare dhe joqeveritare). (Dali Emrullahu)

BURRËRIA. Është status, periudhë e ciklit të jetës, identitet, diskurs dhe praktikë që i referohet kuptimit shoqëror mbi të qenit burrë. Si konstrukt gjinor dhe social merr trajta specifike dhe të ndryshueshme, të cilat dalin nga kontekstet e veçanta shoqërore, politike, historike, kulturore dhe ekonomike. Burrëria perceptohet në mënyra të ndryshme, të cilat lidhen me konceptimet dhe strukturimet shoqërore mbi klasën, racën, etninë, kombësinë, aftësinë dhe seksualitetin. Ka tendencë të shihet si veti e pandryshueshme e mashkullorisë, ku shenjuesi ka fuqinë, pushtetin dhe trimërinë, si dhe posedon veti të caktuara morale, por të idealizuara. Kjo njihet edhe si maskulinitet hegjeonik, që nënkupton përvojat që promovojnë pozitën dominante të

burrave dhe pozitën e nënshtruar të grave dhe janë të ndërtuara mbi heteronormativitet dhe mbi ndarjet e pabarabarta gjinore të pushtetit (të punës, hapësirës, sjelljes, përfaqësimit). Në diskursin popullor shqiptar, burrëria konsiderohet si veti e personave (burrave apo grave) që shfaqin relacione të ndërtuara mbi nocionin e besës (mbajtja e fjalës së dhënë), nderit, ruajtjes së relacioneve patriarkale familjare, patriotizmit, qëndresës dhe moralitetit. Po ashtu, në kontekstin e ligjeve zakonore, burrëria përbën kërkesën dhe vlerën shoqërore për të dëshmuar guxim në zbatimin e normave dhe idealeve shoqërore, veçanërisht, në arbitrimin e konflikteve dhe përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve (pronësore, familjare, ekonomike, politike), në të gjitha nivelet shoqërore. (Nita Luci)

BUSTI I HYJNESHËS DARDANE. Figurë gruaje e skalitur në mermer. U gjet në Kllokot dhe është pa mbishkrim (shek. II-III). Në të paraqitet veshja autoktone, me elemente veçuese



HYJNESH
DARDANE

të kokës, nënkresës që i mbulon flokët dhe shamisë të rënë mbi supet. Ka fytyrë vezake, sy të mëdhenj në trajtë bajameje dhe kapakë të theksuar. Bebzat e theksuara kanë pozitë asimetrike, e djathta më lart dhe e majta më poshtë, që bën

që shikimi të duket hyjnor dhe jashtë realitetit tokësor. Stoli ka vathët e mëdhenj në trajtë të kalaveshit të rrrushit dhe qafore me varëse rrethore dhe sferë të theksuar në mes. Varësja simbolizon diskun diellor, apo vetë diellin, e ngjashme me “Hyjneshën në fron” të periudhës eneolitike dhe të monumenteve të periudhës romake të Hyjneshës Dardane nga Romula Malva (Rumuni) dhe Branetiçiq të Ulët (Serbi). Këto dhe fakti se Hyjneshën Dardane e njihnin të gjithë dhe se vjen nga hapësira jo larg Smirës, ku u gjet monumenti tjetër i saj, bën që monumenti të njihet me emrin “Busti i Hyjneshës Dardane” (më parë: “Busti i gruas nga Kllokoti”). (Edi Shukriu)

BUSHATLLINJTË. Njëra ndër familjet e mëdha shqiptare të shek. XVIII-XIX me origjinë nga Bushati i Shkodrës. I pari pinjoll nga kjo familje, që mori përsipër funksionin e rëndësishëm

të qeveritarit (mytesarifit) të sanxhakut të Shkodrës, ishte Mehmet bej Bushatlliu, i cili u bë themelues i pashallëkut me të njëjtin emër (1771). Pashallëku i Shkodrës ka qenë një nga formacionet politiko-administrative më të mëdha të krijuara në gjysmën e dytë të shek. XVIII në hapësirën shqiptare. Bushatllinjët sunduan pa ndërprerje deri në vitin 1831, duke u kthyer kështu në një dinasti në krye të pashallëkut më jetëgjatë në Shqipëri. Përfaqësuesi më i shquar i derës së Bushatllinjve ka qenë Kara Mahmud Pashë Bushatlliu. Gjatë sundimit të tij (1781-1796), pashallëku arriti kulmin e fuqisë politike dhe të zgjerimit territorial, përfshirë në verilindje edhe pjesë të sanxhaqeve të Dukagjinit, të Prizrenit, të Vuçitërnës dhe të Shkupit. Prirjet e tij të qarta për mëvetësim nga shteti osman i bënë të njohur Bushatllinjët edhe në skenën europiane të kohës. Dy pasuesit e Kara Mahmud Pashës, Ibrahim dhe Mustafa Pashë Bushatlliu, ndonëse ia zgjatën jetën edhe për 35 vjet këtij entiteti politik, përgjithësisht ndoqën rrugën e pajtimit dhe të bindjes ndaj Stambollit. Megjithatë, Mustafa Pasha në vitin e fundit të sundimit të tij udhëhoqi pashallarët e Ballkanit në një nga kryengritjet më të mëdha kundër Portës së Lartë, e cila në fillim të nëntorit 1831 u shtyp nga ushtria osmane. Kjo ngjarje shënoi fundin e Pashallëkut të Shkodrës dhe të dinastisë së Bushatllinjve. Dera e Bushatllinjve e vijoi ekzistencën nëpërmjet një numri të konsiderueshëm familjesh trashëgimtare deri në ditët e sotme. Pashallarët Bushatllinj krijuan një bibliotekë mjaft të pasur me libra e dorëshkrime të vjetra, të cilat sot janë pjesë e fondit të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë. (Ferit Duka)

BUSHI Mehmet 1914-1947). Njëri ndër krerët e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni. Lindi në fshatin Dukagjin të rrethit të Burrelit në Shqipëri. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, kurse Akademinë Ushtarake në Romë. Jetoj në Tetovë. Zhvilloi aktivitet këmbëngulës kundër regjimit jugosllav dhe kundër ideologjisë komuniste. Së bashku me Qemal Skënderin, Azem Moranën dhe Hysni Rudin u dënua me pushkatim (1947). Sipas aktakuzës, M. Bushi kishte qenë anëtarë i organizatës “antipopullore Nacional-Demokratike Shqiptare” dhe kishte punuar për rrënimin e rregullimit ekzistues të RFPJ-së. Ndonëse bëri kërkesë për amnisti, M.

Bushi dhe tre bashkëveprimtarët e përmendur u ekzekutuan. Vetëm Qemal Skënderit dënimi me vdekje iu shndërruar në burg prej 20 vjetësh. Mehmet Bushi dhe dy shokët e tij u pushkatuan diku në Maqedoni. (Daut Bislimi)


BUSHTRANI. Vendbanim rural i tipit të dendur, 12 kilometra në verilindje të Preshevës dhe në lartësi mbidetare 460-520 m. Shtrihet në të dy anët e përroit të Bushtranit, degë e djathtë e Moravicës së Preshevës, në shpatet perëndimore të Rujanit. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 950 ha. Vendbanimi është shumë i vjetër, që dëshmohet nga gërmadhat e një kështjelle dhe gjetjet e tjera arkeologjike. Në vitin 2002, Bushtrani kishte 1,531 banorë rezidentë. Mbi pjesën e epërme të ujëmbledhësit të përroit është ngritur diga, e cila është ndërtuar me qëllim të ujitjes së tokave bujqësore, mbrojtjes nga erozioni dhe vërshimet etj. Deri tani nuk është ndërtuar sistemi për ujitjen e tokave, ndërsa penda shfrytëzohet vetëm për piknik dhe peshkim. (Arsim Ejupi)

BUTKA Spiro (1942-). Ushtarak i Shqipërisë, pjesëmarrës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kreu Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe Akademinë e Përgjithshme në Tiranë. Shërbeu në Gramsh dhe Lushnje dhe më pas në Tiranë, në shkollën e kualifikimit të kadrove. Me reformimin e ushtrisë shqiptare më 1992 u lirua nga ushtria. Pas shpërthimit të luftës në Kosovë ra në kontakt me drejtuesit e UÇK-së dhe kreu detyra për nevojat e luftës. Në mars të vitit 1999 u mor me organizimin dhe zhvillimin e operacionit "Shigjeta" kundër forcave serbe. Me detyrën e zëvendëskomandantit të operacionit mori pjesë edhe në Betejën e Koshares. Pas luftës u ngarkua me detyra në Ministrinë e Mbrojtjes, në kuadër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe më pas në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Në vitet 1999-2000 mori pjesë në organizimin e luftës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Në korrik të vitit 2002 me urdhër të veçantë të UNMIK-ut u dëbua nga Kosova. Është dekoruar nga presidenti i Republikës së Shqipërisë. (Afrim Mustafa)

BUXHETI. Është tërësia e të hyrave dhe e shpenzimeve që planifikon t'i bëjë një qeveri për një periudhë të caktuar kohore, kryesisht

për një vit kalendarik. Në Republikën e Kosovës buxheti prezantohet nga Ministria e Financave dhe miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Buxheti i Republikës së Kosovës përfaqëson shumën e lejuar me ligj, e cila vihet në dispozicion që të shpenzohet për një nënprogram apo për një qëllim specifik, ose, në rastet kur nuk është identifikuar qëllimi specifik, për një kategori të shpenzimeve të një organizate buxhetore, siç është e paraparë me legjislacionin përkatës. Ligji për buxhetin miratohet zakonisht në fund të secilit vit kalendarik. Buxheti i Kosovës përbëhet nga shtatë kategori. Në kategorinë e parë hyjnë të hyrat totale, të cilat përbëhen nga të hyrat tatimore, jotatimore, dividenda, mbështetja e donatorëve, grantet e projekteve e fondet e mirëbesimit. Në kategorinë e dytë hyjnë të gjitha shpenzimet totale, përkatësisht shpenzimet e pagave, të mallrave dhe të shërbimeve, të subvencioneve dhe transfereve, pastaj rezervat, kredidhëniet, shpenzimet kapitale dhe investimet qeveritare. Kategoria e tretë përbëhet nga bilanci primar, ndërsa kategoritë katër dhe pesë paraqesin bilancin e përgjithshëm. Kategoria e gjashtë përfshin financimin, atë të jashtëm dhe të brendshëm dhe kategoria e fundit paraqet bilancin përfundimtar të buxhetit. Që nga periudha e pavarësisë, buxheti i Kosovës, në mesatare, ka pasur rritje të të hyrave nga 7-10% për secilin vit. Pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore, që nga konsolidimi i tij, mbledhen në kufij; vetëm rreth 30% e tyre mbledhen brenda territorit të Kosovës. Rreth 80-85% e të hyrave buxhetore janë të hyra tatimore, pjesa e mbetur janë të hyra jotatimore, dividenda dhe donacione në buxhet. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për shpenzimet, pjesa më e madhe e buxhetit të Kosovës përgjatë këtyre viteve është alokuar për paga dhe mëditje (rreth 30-33%, varësisht nga specifikat e viteve), për mallra dhe shërbime (rreth 13-15%), për subvencione e transfere (rreth 18-22%), për investime kapitale (rreth 30-35%) dhe pjesa e mbetur për rezerva dhe kredidhënie. (Lumir Abdixhiku)

BUXHOVI Jusuf (1946-). Shkrimtar, historian. Lindi në Pejë. Shkollimin e kreu në Pejë dhe në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Është magjistër i shkencave të historisë. Në vitin 1967 filloi punën në gazetën "Rilindja", në fillim gazetar i kulturës, ndërsa në periudhën



JUSUF BUXHOVI

1976-1980 korrespondent i kësaj gazete në Gjermani. Ishte njëri ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në fillimet e tij krijuese në fushën e letërsisë shkroi tregime, pastaj romane, drama, vështrime letrare dhe

shkrime publicistike. Më 1972 botoi përmbledhjen me tregime "Cirku", për të vazhduar me romanet: "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit" (1982), "Nata e shekujve" (1985), "Libri i të mallkuarve" (1987), "Qyteti i dënuar me vdekje" (2000), "Prapë vdekja" (2002), "Letra për kryeprincin" (2003), "Vera e fundit e Gjin Bardhit" (2004), "Vdekja e kolonelit" (2004), "Kujtimet e zonjës fon Braiun" (2005), "Udhëtimi i Mendim Drinit" (2006) "Kodi i dashurisë" (2006), "Jeniçeri i fundit" (2013) etj. Dimensionet e ndryshme të jetës shoqërore, shpirtërore, intelektuale, si temat e realitetit ekzistues, duke e sistemuar përvojën e historisë dhe të aktualitetit, i ka paraqitur në një cikël të madh romanesh me tematikë historike dhe bashkëkohore. Është autor edhe i veprave nga fusha e historisë: "Kongresi i Berlinit 1878" (2008) "Kosova I-V" (2015). Është nderuar me çmime dhe mirënjohje për letërsi. (Sali Bashota)

BUZA Abdurrahim (1905-1986). Pikturor. Lindi në Shkup. Kreu arsimin fillor në Gjakovë dhe në Shkodër. Në vitet 1924-1928 kreu Normalen e Elbasanit. Falë talentit dhe ndihmës së mësuesit të vizatimit, Andrea Kushi, mori të drejtën e studimit në Akademinë e Artit në Torino (Itali) (1928-1929), pastaj në Firence (1929-1933) për pikturë monumentale. Pas kthimit në Shqipëri u emërua mësues vizatimi në shkollën teknike dhe në gjimnazin e Tiranës. Në vitin 1933, bashkë me Odhise Paskalin, themeloi shkollën e vizatimit. Ishte i pari mësues vizatimi në Normalen e Prishtinës në vitin 1941. Nga viti 1946 deri më 1966, kur u pensionua, dha mësim në Liceun e artit "Jordan Misja" në Tiranë. Është nga personalitetet më të shquara të pikturës shqiptare. Originaliteti i tij buron nga forca e talentit dhe karakteri sugjektiv emocional, sidomos në pasqyrimin e motiveve kombëtare. Me portretet e viteve 1933-1936 solli elemente të pikturës moderne, impresioniste e pasimpresioniste. Pikturoi të



ABDURRAHIM BUZA: "VALLJA SHQIPTARE"

parën nudo në Shqipëri (1935), në kohën kur vajza tiranase mbulohej me ferexhe. Në veprën e tij mishërohet shpirti i shqiptarit, gëzimet dhe hidhërimet, lindjen, dasmat, vdekjen, idealin për liri dhe flijimin për atdhe. Krijimtaria e A. Buzës përfshin një numër të madh punimesh në teknika të ndryshme. Disa prej tyre janë pronë e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë, në ndonjë galeri jashtë vendit, por pjesa më e madhe e veprave të tij ruhet në studion-muze "Buza" dhe në disa koleksione private e shtetërore. Ishte pjesëmarrës në ekspozitën e parë kombëtare, pas çlirimit, më 1945 në Tiranë. Veçohen: ekspozita në Galerinë e Arteve në Prishtinë dhe ajo në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë (1980), pastaj ekspozita retrospektive në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë (1982). Mori pjesë në ekspozita: në Itali, Austri, Francë, Gjermani, Kinë, Rusi, Bullgari, Hungari, Armeni, Egjipt, Greqi, Zvicër, Angli dhe Maqedoni. Ishte bartës i titullit "Pikturor i Popullit" (1979), ndërsa më 1984 mori Çmimin e Republikës të kl. I. (Tahir Emra)

BUZA Ali (1948-). Inxhinier mekanik, udhëheqës në organizata punuese. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për inxhinieri mekanike në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1973). Veprimtarinë profesionale e filloi si mësëmdhënës në Qendrën për aftësimin e kuadrove në kuadër të Entit për Inkuadrim në Prishtinë (1973-1976), në Odën

Ekonomike të Kosovës (1977-1978) dhe më pas vazhdoi veprimtarinë në Gjakovë, fillimisht në Fabrikën e Elektromotorëve (1979-1980) dhe më vonë drejtor në “Gorenje-Elektromotorët” (1980-2013). Është themelues i Bankës Ekonomike si shoqëri aksionare në Gjakovë (1991), i organizatës për eksport-import “EKSIM” dhe i degëve të saj në Stamboll, Tiranë dhe Shkup. Kreu edhe një sërë detyrash dhe funksionesh në institucione dhe asociacione ekonomike të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. (Vjollca Komoni).

BUZA Kujtim (1937-). Piktur, kritik arti. Lindi në Tiranë, ku kreu gjimnazin dhe liceun artistik. Vazhdoi studimet në Histori Filologji të Universitetit të Tiranës. Më 1959 nis studimet për pikturë, teori arti e kritikë në San Petersburg dhe i përfundoi në Institutin e Lart të Arteve, Tiranë, më 1964. Është i njohur për peizazhet e trojeve shqiptare, ku shquhet cikli “Nëpër vende historike të Kosovës”. Ka ndikuar në njohjen e artistëve të Kosovës. Është autor esesh, studimesh e monografish. Ka qenë drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë, përgjegjës për artet vizuale në Ministrinë e Kulturës, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, profesor në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe dekan i departamentit të tekstilit pranë saj. Ka marrë pjesë në ekspozita kombëtare nga viti 1964. Ka hapur ekspozita vetjake në Tiranë dhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe ka marrë pjesë në ekspozita të përbashkëta në Francë, Kinë, Egjipt, Turqi, Itali, Greqi, Angli, Zvicër, Austri, Australi, Gjermani, Kosovë, Maqedoni, Suedi dhe SHBA. U veçua ekspozita “Tre brezat Buza” në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë, më 2005. Veprat e tij gjenden në muze e koleksione private. Është vlerësuar me Urdhrin “Naim Frashëri”, me Urdhrin e Flamurit dhe “Piktur i merituar”. Ka fituar disa çmime të para kombëtare për peizazh dhe çmimin për studimet kritike “Autorë dhe vepra” (1982). (Tahir Emra)

BUZA Shaban (1959-). Inxhinier i makinërisë, profesor universitar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës (UP). Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Mostarit (Bosnjë e Hercegovinë), ndërsa tezën e



SHABAN BUZA

doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së. Që nga viti 1984 punon në këtë fakultet, ku mori të gjithë titujt universitarë. Kreu detyra të ndryshme në Fakultetin Inxhinierisë Mekanike dhe funksione drejtuese

në UP. Ligjëron lëndët nga lëmi i konstruktimit dhe i dizajnit. Ndoqi kurse, trajnime, specializime dhe hulumtime në shumë vende europiane. Ishte koordinator në disa projekte të realizuara në UP. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, i dispensave dhe i teksteve universitare (“Mekanike teknike”, ushtrime; “Rezistenca e materialeve”, përmbledhje detyrash etj.). Mori pjesë në simpoziume dhe konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2015 u zgjodh rektor i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë. (Xhevat Perjuci)

BUZMI. Te shqiptarët e krishterë është rit pagan që bie në natën e Kërshëndellave, tri ditë mbasi të kthejë moti mbarë, ndërmjet 24 e 25 dhjetorit. Është një ritual familjar, që simbolizon këndelljen e jetës dhe begatinë. Në ditën e parë të natës së Kërshëndellave (24 dhjetor) një burrë i familjes shkon në mal dhe pret një dru dy-tre vjeçar, të cilin e sjell në shtëpi. Ky është buzmi. Në mbrëmje druri shkurohet dhe anëtarët e familjes, të gjithë së bashku (përveç të zotit të shtëpisë dhe të shpëneshtës) dalin dhe e marrin nga një pjesë të buzmit për ta futur brenda. Renditen sipas moshës, pa dallim gjinie dhe hyjnë brenda njëri pas tjetrit, duke thënë: - Koftë mirë, o i zoti i shtëpisë. Kurse i zoti i shtëpisë përgjigjet: - Mirë se vjen, me çka po vjen? Tjetri i përgjigjet: - Me djem e me çika, me nuse e bija, me mbesa e nipa. Pastaj hyn tjetri, i cili thotë se po vjen me grurë e kollomoq, me elb e thekër, me fasule e patate. Tjetri thotë se po vjen me lopë e me dele dhe deri të i fundit, i cili thotë se po vjen me të gjitha të mirat e Zotit. Pastaj plaku e vendos buzmin në zjarr dhe në qoshe të tij, ku është i skalitur një kryq, e vendos një qiri. Aty pranë qet pak grurë të zier, një pjesë të kulaçit, raki e verë. Dhe fillon të urohet festa. Sofra me plot bereqet në të mbetet e shtruar tërë natën. Më pas buzmi nxirret jashtë. Diku

qitet ditën e Kërshëndellave (25 dhjetor), diku pas tri ditësh. Në lamë bëhet një kryq me kashtë dhe buzmi duhet të sillet një herë nëpër lamë, pastaj shkohet te çdo pemë, ku një burrë i shtëpisë i drejtohet pemës me sëpatë në dorë: - A ban, a të preva? Tjetri i përgjigjet: - Fale, fale se ban, ban! Kështu shkohet deri te pema që dëshirohet të mbushet me fruta dhe aty vendoset buzmi. (Frrok Kristaj)

BUZOLLI Sami (1969-). Boksier. Lindi në Prishtinë. Boksoi për “Radniçkin” e Prishtinës dhe më 1977 u shpall kampion i ish-Jugosllavisë për të rinj në kategorinë bantam. Më 1978 u shpall nënkampion i ish-Jugosllavisë, kurse më 1979 arriti vendin e tretë. Në 1978 dhe 1979 ai gjithashtu fitoi medaljen e bronzit në Kampionatin Ballkanik, ndërsa në vitin 1981 mori pjesë në Kampionatin Europian në Tampere, ku fitoi medaljen e argjendtë. Më 1982 në Kampionatin Botëror në Munihi doli i treti dhe mori medaljen e bronzit. Në vitin 1983 ishte kampion i ish-Jugosllavisë dhe përsëri fitoi medaljen e bronzit në Kampionatin Ballkanik. (Lulzim Shala)

BUZUKU Beqir (1948-). Shkrimtar. Lindi në Tugjeç të Kamenicës. Kreu shkollën tetëvjeçare në vendlindje, shkollën e mesme në Kamenicë, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjiçan. Punoi si nëpunës kontabiliteti, më pas përkthyes në administratën e komunës dhe një kohë të shkurtër në arsim. Që kur ishte nxënës gjimnazi punoi si korrespondent i gazetës “Rilindja. Përveç gazetarisë u mor edhe me shkrime letrare. Shkruan poezi dhe prozë për fëmijë dhe të rritur. Krijimet e para i botoi në gazetën dhe revistën e kohës. Deri më tani botoi veprat: “Pesha e ngjyrave” (1995), “Eti për buzëqeshje” (1995), “Çupëza e ngjyrave” (1996), “Përtej të sotmes” (1997), “Lahuria e lulemollëve” (2001), “Çelësat majë lapsi” (2004), “Rrëshqitje në udhëkryq” (2005), “Tri ditët e shtojzovalles” (2009), “Atdheu me dy zemra” (2014). (Munish Hyseni)

BUZUKU Gjon Bdek (sh. XVI). Autori i librit të parë të botuar shqip, “Meshari” (1555). Nuk dihen të dhënat për personalitetin e tij, as vendi e data e lindjes dhe e vdekjes. Ishte famullitar me shërbim jashtë hapësirës së trungut shqiptar. Lucia Nadin mendon se ka shërbyer në Venecia apo aty afër në Republikën e Venedikut. Mbiemri Buzuku, Buzuku dhe


gjuha e veprës na orientojnë që prejardhjen e tij ta kërkojmë te zonat e Ulqinit e të Tivarit, konkretisht në Krajë. Nuk dihet vendi i botimit të librit. Ka pasur hipoteza të ndryshme. L. Nadin mendon të jetë shtypur në Venedik. Ruhet një kopje e vetme e dëmtuar. Ka 94 fletë të plota, ndërsa ka pasur 110 fletë. Prej tyre 12 janë zhdukur tërësisht, 4 janë ruajtur vetëm në kinde. Në fletët pa tekst ka shënime të atyre që e kanë pasur në dorë. Mungon ballina. U shtyp në dy shtylla në formatin in-quatro me karaktere gotike të Italisë Veriore. Lënda që përmban libri është nga Breviari, fletët 1-20, nga Meshari, fletët 30-110, nga Katekizmi dhe Ritualit – fl. 21-29, pra nga kulti katolik romak. M. Roques e quante “libër i orëve dhe meshar”, ndërsa përmbajtja kryesore e tij është nga Breviari - Meshari. Tekstet në libër janë më shumë dhe më shpesh të Dhjatës së Re. Më 1743 Gj. N. Kazazi e kishte parë në Kolegjin e Propaganda Fide-s në Romë dhe një copë të kopjuar ia kishte dërguar atë Guxetës në Seminarin e Palermos. Në fund të shek. XVIII u bart në koleksionin e librave fetarë lindorë të kardinalit Borgia. Ndodhet në Bibliotekën e Vatikanit me signaturën R(accolta)G(enerale) L(iturgia). III. 194. U rizbulua më 1909 nga E. Ehrle e P. Skiroi. Më 1932 atë Justin Rrota mori tri kopje të riprodhuara për Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Kazazi e quajti “Meshar” dhe me këtë emër në thonjëza njihet sot. Si ka ndodhur që libri i parë shqip të jetë ruajtur vetëm në një kopje të dëmtuar? Disa e kanë shpjeguar këtë humbje me pushtimin osman; ka supozime se mund të jetë ndaluar në kuadër të tensioneve Reformë/ Kundërrreformë; Çabej e ka mbështetur supozimin e J. Tomiqit (Tomić), pas të cilit censura e Romës e kishte penguar përhapjen e librit për arsye fetare dhe nga droja e përhapjes së ndjesive kombëtare ndër shqiptarë; Riza mendonte se Kuria e Romës ishte e pakënaqur me përkthimin. Në Index Librorum Prohibitorum nuk ka shënim. Pal Skiroi më 1932-33 botoi fragmente me transkriptim në bashkëpunim me G. Petrotën (Petrotta) dhe F. Ribeccon (Ribezzo). J. Rrota është botues i rëndësishëm i pjesëve nga vepra e Buzukut të “Hylli i Dritës” e si botim i veçantë më 1930, më 1938, 1940. Me leksikonin e Buzukut janë marrë S. Men (Mann) dhe M. La Piana, ndërsa një vjellje më të plotë me 2,114 fjalë e ka bërë K. Ashta (Mann ka gjetur rreth 2,700 fjalë). Namik Ressuli ka botuar më 1958

tekstin e plotë me riprodhim mekanik dhe me tejkshkrim në alfabetin e sotëm me elemente të tejkshkrimit fonetik të shoqëruar nga aparati kritik. Parathënia shtron dilemat, vështirësitë që ka ndeshur ai. U ribotua më 2013. Eqrem Çabej ka botuar studime të gjera për gjuhën dhe figurën e Buzukut në vitet 1955-1956. Më 1958 ai e ka përfunduar botimin kritik të "Mesharit" me studim, transliterim e transkriptim e shënime në dy vëllime, por ka dalë nga shtypi vetëm më 1968. Është ribotuar në Prishtinë me riprodhime të reja më 1987 dhe më 1988 dhe në Tiranë më 2013. Ky është botimi më i plotë kritik. Botimet kritike janë ndjekur me studime të tjera. S. Riza ka studiuar aspektet gjuhësore, të grafisë, të përkthimit, letraret, etj. M. Camaj më 1961 ka botuar librin "Meshari i Gjon Buzukut". Më 2004 ASHAK-u ka botuar monografinë për sistemin foljor të shqipes në gjuhën e Buzukut të Vilfrid Fidler-it (Wilfried Fiedler). Janë mbajtur disa konferenca shkencore me studime për Buzukun dhe veprën e tij. Ka një version të "Mesharit" në Internet. "Meshari" i Buzukut ka vlerë të madhe për kulturën shqiptare dhe për studimin e lëvizjeve kulturore në Ballkan. Ka shkruar një shqipe me tendencë kultivimi, me vlera stili, sidomos në përkthimin e psalmeve e të himneve. Cilësia, sasia e tekstit të përkthyer, kultura e shkrimit ia shtojnë vlerën librit. Rëndësi ka për gjuhën liturgjike. Për studimin e shqipes është burim i pashtershëm. Shënon fillimet e epokës së shqipes letrare. Gjuha e veprës është gegërishtja veriperëndimore. Disa nga psalmet paraqiten me versione të ndryshme. Kjo, begatia gjuhësore, shkalla e normalizimit të gjuhës, indikojnë përdorime të shqipes në shkrime të këtij lloji dhe nga autorë e hapësira të tjera. Janë vërejtur elemente të veçuara të toskërishtes. Libri është shtypur me shkronja latine me 5 plotësime nga alfabeti grek dhe ciriliku. (Rexhep Ismajli)

BUZHALA Berat (1975-). Gazetar. Lindi në Çabiq të Klinës. Shkollën fillore e kreu në Ujëmir, të mesmen në Klinë, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës (1998). Me gazetari filloi të merret që nga viti 2000, fillimisht në gazetën e përditshme "Zëri", si gazetar i ekonomisë dhe pastaj si gazetar hulumtues në gazetën "Koha ditore". Më 2004, së bashku me një grup gazetarësh, themeloi gazetën e përditshme "Express", ku ishte zëvendëskryeredaktor dhe më pas kryeredaktor. Në vitin 2009 u

përfshi në politikë, në Partinë Demokratike të Kosovës, dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. Pas një kohe iu kthye gazetarisë, sërisht në gazetën "Express", tani e shndërruar në projektin më të suksesshëm rajonal të gazetarisë online. U shpërblye me çmime dhe mirënjohje për punë të suksesshme në gazetari. (Muhamet Mavraj)

BUZHALA Prend (1951-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Çabiq të Klinës. Kreu shkollimin filor në Ujëmirë, gjimnazin në Klinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin



PREND BUZHALA

Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1982 u burgos për shkaqe politike. Punoi si mësime në shkollën e mesme të Klinës, zyrtar dhe drejtues i arsimit komunal të Klinës, gazetar dhe redaktor në disa revista dhe gazeta. Me shkrime letrare u mor që në rini. Veprat e botuara deri tani: "O Amë, O Amë" (1995), "Për kë bie kabanë e re" (1998), "Shtatë seanca pranë Apokalipsit" (1998), "Këpucët e rënda të lirisë" (2010), "Çaste lirike" (2014), "Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë" (2003), "Tregime të shenjta" (2014). Botoi kritika dhe studime, të cilat i përmbloodhi në librat: "Metafora e vendlindjes" (1999), "Përqsje estetike" (2000), "Ex libris, I" (2003), "Odeoni i fjalës" (2003), "Shkrimtari pranë buzëqeshjes" (2005), "Muza e zemrës" (2006), "Temë dhe tekst" (2006), "Muza e kujtesës" (2007), "Aty ku krizat i besohen engjëllit" (2008), "Res Publica e shkrimtarit" (2008), "Kode poetike të mbijetesës shpirtërore" (2009), "Gjenitivi i lirikës" (2009), "Të folurit e kryqëzimit shqip" (2011), "Amëza e rrëfimit" (2012), "Dëshmia për plagën e ftohtë" (2012), "Klasiku modern i tekstit" (2013), "Në mbrojtje të imagjinatës" (2014), "Gjakimi i bukurisë" (2014) etj. (Munish Hyseni)

BUZHALA Rustem (1952-). Sociolog, mësime në shkollën fillore e kreu në Ujëmir, të mesmen në Klinë, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës (1998). Me gazetari filloi të merret që nga viti 2000, fillimisht në gazetën e përditshme "Zëri", si gazetar i ekonomisë dhe pastaj si gazetar hulumtues në gazetën "Koha ditore". Më 2004, së bashku me një grup gazetarësh, themeloi gazetën e përditshme "Express", ku ishte zëvendëskryeredaktor dhe më pas kryeredaktor. Në vitin 2009 u

Zagrebit, në Fakultetin e Shkencave Politike (1988), ndërsa studimet e doktoratës në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës më 2007. Punoi fillimisht si mësues në komunën e Suharekës, pastaj në gjimnazin “Sami Frashëri” dhe në shkollën e mesme teknike “19 Nëntori” në Prishtinë. Nga viti 1986 filloi të punojë si mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës dhe më pas në Fakultetin e Edukimit. Ka kryer detyra të ndryshme në institucionet qendrore dhe lokale. Është autor i monografisë “Me shqiptarët në Turqi” dhe i disa punimeve nga fusha e integritit të komuniteteve etnike, kryesisht atij shqiptar në Turqi. (Ardian Gola)

BYCI Agim (1947-). Shkrimtar, botues. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse studimet e gjuhës dhe të letërsisë angleze në Prishtinë. Pos me poezi, që herët filloi të shkruante ese, recensione dhe kritikë letrare. U mor edhe me përkthime. Është veprimtar në jetën kulturore të Gjakovës, sidomos në kuadër të Klubit letrar “Gjon Nikollë Kazazi” dhe të “Mitingut të Poezisë”. Formoi Shtëpinë Botuese “Fan Noli” dhe çmimin letrar po me këtë emër, që u jepet poetëve të dalluar për vepër jetësore. Shkruan për fëmijë dhe për të rritur. Poezia e tij për fëmijë shquhet për shprehjen koncize dhe për humorin e lehtë e të këndshëm, kurse poezia për të rritur shquhet për satirën e rreptë. Një vend me rëndësi në veprimtarinë e tij zë edhe enigmatika për fëmijë. Veprat e botuara: “Kur bie maska” (1977), “Horoskopi punon për ne” (1997), “Mozaiku i ndarjes” (1997), “Sot e mot qesh me lot” (1999) etj. (Arif Demolli)

BYLYKBASHI Enver (1960-). Fotoreporter. Lindi në Hade. Shkollimin e kreu në Prishtinë. Në vitet 1982-1983 punoi fotoreporter në gazetën studentore “Bota e re”, ndërsa në vitet 1984-1992 ishte fotoreporter në redaksinë revistave të “Rilindjes”. Në vitet 1992-1999 ishte redaktor i fotografisë në revistën “Kosovarja” dhe më pas fotograf në Arkivin e Kosovës dhe redaktor i fotografisë në revistën “Ekskluzive”. Nga viti 2003 punon në Galerinë e Arteve të Kosovës. Në periudhën 1981-1999 botoi shumë fotografi në gazeta, revista dhe botime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë në shumë ekspozita të fotografisë artistike. (Ibrahim Berisha)

BYLYKBASHI Ilaz (1955-). Fotoreporter. Lindi në fshatin Baicë të Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Gjiilan. Studio në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Punën e fotoreporterit e filloi më 1979 në gazetën studentëve “Bota e re”, ndërsa nga viti 1982 punoi si fotoreporter në gazetën “Rilindja”. U bë kronist i ngjarjeve më të rëndësishme të atyre viteve, siç ishin demonstratat e vitit 1981, protestat masive kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës, protestat e minatorëve, aksioni i pajtimit të gjaqeve, dalja në skenë e UÇK-së, masakra ndaj familjes Jashari, masakra e Reçakut, eksodi masiv i vitit 1999 etj. Një pjesë të punës së tij e ka përmbledhur në librin “555, kronikë, 1981-1995” (1996). Nga viti 1999 jeton në Melburn të Australisë. (Bajrush Morina)

BYLYKBASHI Shefqet (Shefqet Kapetani) (1910-1969). Veprimtar i lëvizjes antikomuniste, i burgosur politik. Lindi në Baicë të Drenicës. Mësimet e para i mori në Arllat dhe në Medresenë e Gjakovës. Kreu Akademinë Ushtarake në Tiranë më 1931. Si ushtarak nga viti 1931 e deri më 1939 punoi në Gardën Mbretërore në Postribë, Burrel, Maqellarë dhe Tiranë. Në periudhën 1939-1942 qëndroi në Itali, në Gardën Mbretërore Shqiptare. Pas kthimit në Shqipëri caktohet oficer i rekrutimit në Tropojë (1943). Me formimin e Regjimentit IV të Ushtrisë Shqiptare në Prishtinë, u caktua oficer në këtë regjiment. Në shtator të vitit 1943 emërohet komandant i artilerisë për mbrojtjen e vijës së kufirit me Serbinë, e cila shtrihej nga Karadaku i Preshevës deri në Podujevë. Kontribuoi që në tri betejet, të cilat u zhvilluan gjatë vitit 1944 kundër partizanëve serbo-maqedonas dhe ushtrisë bullgare (Velegllavë, Kikë dhe Hajkobillë-Dabishec-Prapashticë) t’u shkaktojë armiqve humbje të mëdha. Pas këtyre sukseseve, Lidhja e Dytë e Prizrenit e ngriti në gradën major. Pas depërtimit të njësiteve partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë në territorin e Kosovës në nëntor të vitit 1944, Sh. Bylykbashi e vazhdon rezistencën me disa bashkëluftëtarë. Në fillim të vitit 1945 kapet nga organet e sigurimit në malet e Berishës, u burgos dhe më pas u dënua me 8 vjet burg. Pas daljes nga burgu, e kaloi jetën në burg shtëpiak. Në vitin 2010 u dekorua nga Presidenti i Kosovës me Medaljen e Artë të Lirisë. (Fehmi Rexhepi)

BYTYÇI Agim (1944-). Punëtor sportiv. Lindi në Prizren. Ishte aktiv si futbollist nga viti 1963 deri më 1970 në ish-KF “Metohia” (tash “Liria”). Në postet drejtuese të KF “Liria” ishte prej vitit 1980 e deri më 2002. Ishte kryetar, nënkryetar dhe anëtar i kryesisë për 22 vjet rresht. Ishte kryetar i parë i Federatës së Futbollit të Kosovës, pas pavarësimit të sportit kosovar më 1991. Ishte bartësi kryesor i zhvillimit të garave që kundërshtonin masat e dhunshme serbe, duke organizuar jetën e pavarur sportive në Kosovë. Ishte anëtar i kryesisë së Federatës së Sporteve të Kosovës prej vitit 1991 deri më 2001. Në ato vite Federata e Sporteve e Kosovës ishte në krye të organizimit sportiv në Kosovë. (Vllaznim Bytyçi)

BYTYÇI Agron (1974-). Pikturor. Lindi në Kravaseri të Malishevës. Më 1996 mbaroi Fakultetin e Arteve, drejtimi i pikturës. Që nga anëtarësimi në Shoqatën e Artistëve Figurativë të Kosovës ishte pjesëmarrës në të gjitha ekspozitat dhe aktivitetet e saj figurative. Në periudhën 1999-2002 punoi në Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Prishtinë, si pikturor restaurues. Më 2003 u zgjodh pedagog i pikturës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku është edhe sot. Krijimtaria e tij shquhet për frymën e njohur të shkollës surrealistike. Mbafti një sërë ekspozitash personale, siç është ajo në Foajeun e Teatrit Kombëtar në Prishtinë (2001), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës po në Prishtinë, (2004), në Shtëpinë e Kulturës në Mitrovicë (2005), sërish në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2006), pastaj në “Agora Gallery” në Nju-Jork (2008), në Galerinë e Arteve në Shkodër (2009), në Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë (2013). Mori pjesë edhe në disa ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Është laureat i çmimeve “Hyu i Prishtinës” (2001 dhe 2002), “100-vjetori i lindjes së Nënë Terezës” akorduar nga Galeria e Arteve të Kosovës (2010), në manifestimin kulturor “Flaka e Janarit” (2014) etj. (Rexhep Ferri)

BYTYÇI Ardiana (1983). Mezosoprano. Lindi në Prishtinë. Është këngëtare e skenës koncertale muzikore në Kosovë dhe më gjerë. Ka një potencial zërthimi linjash dramatike te veprat operistike. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, ndërsa studimet në “Hochschule für Musik Detmold” në Gjermani

më 2009. Në periudhën 2006-2009 ishte soliste me Teatrin “Opernwerkstatt am Rhein”, në audicionin prestigjioz “Hans Gabor Belvedere” në Vjenë, duke hyrë në mesin e 3,500 konkurruesve në rrethin e njëzet më të mirëve për operë/operetë. Më pas veprimtaria e saj artistike u shtri në shumë skena. Ka realizuar një repertor të pasur operistik me role kryesore në operat “Cavaleria rusticana”, “Carmen” etj., me vlerësime të larta nga kritika muzikore. Më 2010 mori pjesë në festivalin “Lieder ohne Grenze” në Gjermani; më 2011 realizoi koncert solistik në katedralen “Sant Ignazio” në Romë. Veprimtarinë e vazhdoi brenda dhe jashtë vendit. Është koriste-soliste në Filarmoninë e Kosovës. (Sami Piraj)

BYTYÇI Astrit (1975-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Ferizaj. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në prill të vitit 1998 u rreshtua në radhët e UÇK-së, në Zonën e Drenicës. Aktivitetin luftarak e vazhdoi në Ferizaj, më pas iu bashkua ushtarëve që shkonin për armatim në Shqipëri (nëntor 1998). Më 13 dhjetor 1998, së bashku me shumë ushtarë të tjerë, me pajisje dhe armatim, të prirë nga komandant Mujë Krasniqi, nga Shqipëria hyjnë në Kosovë. U vra më 14 dhjetor 1998, kur bashkë me 148 luftëtarë të tjerë në kolonë, në malet e Pashtrikut ra në pritën e forcave serbe. (Ruzhdi Jashari)

BYTYÇI Bajram (1926-1996). Afarist dhe lider biznesi. Lindi në Suharekë, mësimet fillestare i mori në shkolla fetare, ndërsa më vonë përfundoi Shkollën e Lartë Ekonomike në Pejë. Arritjet e tij më të mëdha në fushë të biznesit lidhen me themelimin dhe udhëheqjen për shumë vjet (1964-1984) të Kombinatit “Ballkan”, prodhuesit të rripave trapezoid dhe konvejerëve në Suharekë. Nën udhëheqjen e tij ky kombinat ndërtoi pozicion të fuqishëm konkurrues në tregun jugosllav, në tregun europian dhe më gjerë. Nën udhëheqjen e B. Bytyçit, “Ballkani” u bë njëri nga promotorët e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe ndikoi në transformimin arsimor e social të komunës së Suharekës, e cila më parë hynte në komunat e pazhvilluara. Si drejtor i “Ballkanit” ai afroi pranë vetes stafin më të përgatitur të kohës, inxhinierë, ekonomistë dhe profile të tjera

të një kuadri të shkolluar dhe të specializuar. B. Bytyçi ishte edhe deputet në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë dhe nënkryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. (Selman Selmanaj)

BYTYÇI Bajrush (1946-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Sllovi të Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë në Rijekë të Kroacisë (1971). Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimitarisë në Zagreb, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1986). Punoi si inxhinier në ndërmarrjen e prodhimeve metalike dhe plastike “Famipa” në Prizren dhe në Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë. Më 1980 u zgjodh asistent dhe më pas avancohet në tituj të tjerë universitarë, më 1997 merr titullin profesor ordinar. Kreu funksione të shumta në ndërmarrjet ekonomike dhe në institucionet e arsimit të lartë. Botoi disa tekste universitare, kryesisht nga fusha e saldimit, që ishte fushë e specializimit të tij profesional dhe shkencor. (Hysni Osmani)

BYTYÇI Cen (1957-). Mjek, ortoped, profesor universiteti. Lindi në Zogaj, komuna e Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Pejë. U diplomua në Fakultetin



CEN BYTYÇI

e Mjekësisë në Prishtinë (1982). Fillimisht punoi në repartin e ortopedisë në Spitalin Rajonal të Pejës. Specializimin nga ortopedia dhe studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb, kurse disertacionin e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1997). Në vitin 1997 u zgjodh asistent, më 2009 arrin gradën e profesorit të rregullt të ortopedisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Qëndroi për aftësim profesional në shumë qendra spitalore, si: në Zvicër, Francë, Gjermani etj. Gjatë luftës së fundit në Kosovë veprroi si kirurg ortopedik me ekipin kirurgjik në terren për trajtimin e të plagosurve në luftë. Si autor dhe bashkautor publikoi shumë punime shkencore dhe mori pjesë në disa kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare. Është pro-

fesor i ortopedisë me traumatologji në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Avdyl Krasniqi)

BYTYÇI Fatmir (1972-). Gazetar i sportit. Lindi në Arllat të Drenasit. Studio për gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punën si gazetar e filloi në vitin 1998 në gazetën studentore “Bota e re”. Pas luftës punoi rreth dhjetë vjet në të përditshmen “Epoka e re”; në vitin 2008 kaloi në gazetën “Infopress”, ku qëndroi deri në vitin 2010 dhe më pas në agjencinë e lajmeve “Kosovapress”. (Florim Maliqaj)

BYTYÇI Fatos (1980-). Gazetar. Lindi në Arllat të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Arllat dhe Drenas, ndërsa studimet për gazetari në Prishtinë. Kreu studime plotësuese për ngritje profesionale në Britani të Madhe (2011). Një kohë punoi në Institutin për Raportime të Luftës e Paqes (IWPR), pastaj në gazetën “Zëri” dhe në Radiotelevizionin e Kosovës. Më pas u bë korrespondent i agjencisë së lajmeve “Reuters” (2006). Është laureat i disa çmimeve profesionale për raporte televizive (2003 dhe 2004), përfshirë edhe çmimin për raportin më të mirë në televizionet publike të Europës Juglindore, të ndarë nga Unioni i Transmetuesve Europianë (EBU). Punon korrespondent i agjencisë “Reuters” në Prishtinë. (Gazmend Sylja)

BYTYÇI Mustafë (1947-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Istog, arsimimin bazë e mori në Istog, në Prizren dhe në Pejë. Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1972. Zgjidhet asistent në katedrën e fizikës (1973), ku më pas gradohet në të gjithë titujt universitarë. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1984), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së. Është autor i teksteve universitare “Fizika për studentët e kimisë” (1988) dhe “Historia e fizikës” (2005) dhe i disa teksteve për shkolla të mesme. Ka botuar punime shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore nga fusha e fizikës bërthamore. Për ngritje profesionale dhe shkencore ka qëndruar në disa qendra shkencore jashtë vendit. Ka kryer detyra dhe funksione në institucionet e shkollimit të lartë të Kosovës. (Rexhep Gashi)

BYTYÇI Ndue (1847-1917). Poet, meshtar, mësues. Lindi në fshatin Bytyç, në rrethinë të Shkupit. U shkollua në Kolegjin Saverian të Jezuitëve në Shkodër. Shërbeu si prift në Pejë, Prizren, Gjakovë dhe në lokalitete të tjera të Malësisë së Mbishkodrës. Njëkohësisht punoi si mësues në Dioqezën e Shkupit dhe të Pejës. Kishte njohuri të gjithanshëm fetare, filozofike dhe filologjike. Ishte njohës i mirë i letërsisë klasike. Vepra “Vjersha fetare” mbeti në dorëshkrim, sikundër edhe teksti i shqipëruar i Psalmëve të Davidit. Shkroi poezi dhe trajtoi motive të ndryshme. Në vjershat e tij fetare bëjnë pjesë: “Mundimet e Jezu Krishtit”, “Vaji i Zojës së Bekueme”, “Shpirti em e madhnon Zotin!”, “Atyna”, “Udha e Krygjës”, “U baftë vullnesa yte” etj. Në veprën e atë Jak Jungut “Kulshedra e shpirtit sbulue t rriive”, në kapitullin “Shahiri Elierz” u botuan vjershat “Peshkaxhija”, “Çobejt”, “Mymleqeti”, “Barkaxhija”, “Lugati” dhe “Kastigimi”. Bytyçi është poet romantik. Krijoi poezi patriotike dhe sociale. Më 1887 në Shkodër botoi poezinë “Mymleqeti” (Atdheu). Vargje poetike ia kushtoi atë Leonardo de Martinos. Ishte njëri ndër poetët e parë shqiptarë që kultivoi sonetin. Botoi kryesisht në revistat e jezuitëve “Lajmëtari i Zemrës së Krishtit”, “Leka” etj. (Isak Shema)

BYTYÇI Nuhi (1955-). Gazetar. Lindi në Shkozë të Malishevës, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për gazetari në Prishtinë. Gjatë viteve ’70 nisi gazetarinë në gazetën e studentëve të Universitetit të Prishtinës “Bota e re” dhe nga viti 1975 në Radiotelevizionin e Prishtinës, në redaksinë e emisioneve dokumentare. Pas mbylljes së Televizionit të Prishtinës nga Serbia (1990), një kohë ishte redaktor i emisionit të lajmeve në gjuhën shqipe në Radio-Kroacia në Zagreb, pastaj korrespondent i disa radiotelevizioneve të diasporës në gjuhën shqipe si “Zëri i shqiptarëve” në Berlin, i Televizioni “Victoria” në SHBA etj. Në vitet 1998-1999 udhëhoqi ekipin e Televizionit të Prishtinës që punonte për Televizionin Shqiptar, për lajme nga Kosova. Pas vitit 1999 realizoi në Radiotelevizionin e Kosovës një sërë dokumentarësh për luftën çlirimtare në Kosovë. Nga viti 2011 është udhëheqës i programit satelitor të Radio Televizionit të Kosovës (RTK). (Artan Krasniqi)

BYTYÇI Sali (1962-). Studiues i letërsisë, publicist. Lindi në Dejë të Rahovecit. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Ratkoc dhe në Rahovec, ndërsa studimet për letërsi shqipe i ndoqi në Universitetin e Prishtinës. Është punëtor shkencor në degën e letërsisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Veprat e botuara: “Rekuem për lisat” (1994), “Labirinteve të tekstit letrar” (2003), “Simbolet florike dhe zoomorfike në poezinë e sotme shqipe, 1945-2000” (2008), “Fjalë prej guri - Vepra letrare e Azem Shkrelit” (2010), “Prej pseudoteorive deri te plagjiatura” (2011). Përveç interesimit të tij për poezinë, shfaqti interes edhe për kritikën letrare, për tekste recensuese e polemike. Ishte i dënuar politik nga regjimi jugosllav dhe më pas edhe rob lufte nga viti 1998 deri në tetor të vitit 2000. Opresioni është njëri ndër motivet e krijimtarisë së tij në poezi. (Kujtim Rrahmani)

BYTYÇI Vllaznim (1964-). Gazetar i sportit, mësimdhënës. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Përfundoi studimet në Fakultetin e Edukimit. Hapat e parë në gazetari sportive i nisi në vitin 1992 në revistën “Sporti” në Prizren. Më pastaj vazhdoi në gazetën “Bujku”. Në këtë të përditshme raportoi për aktivitetet e përgjithshme sportive nga komuna e Prizrenit. Më pastaj pati edhe angazhime të tjera në disa radio lokale. Me fillimin e botimit të gazetës sportive “Kosova sport” (2001) u angazhua si korrespondent nga Prizreni. Një kohë raportoi edhe për të përditshmen “Zëri” dhe vazhdoi të jetë korrespondent i së përditshmes sportive “Sport plus”. Si reporter i sportit punoi edhe për disa televizione dhe Radio Dukagjinin. Kuvendi Komunal i Prizrenit disa herë e ka shpallur gazetarin më të dalluar. (Besim Kajtazi)

BYTYÇI Veli (1960-). Gazetar. Lindi në fshatin Shkozë të komunës së Malishevës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Prizren. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës (1983). Po më 1983 filloi punën në gazetën e përditshme “Rilindja”, korrespondent në Rahovec dhe në Prizren. Në vitet 1993-1998 ishte nënkryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës dhe deputet i kësaj partie nga zgjedhjet e vitit 1992, të organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në vitet 1993-1999 ishte deputet nga

Kosova i Partisë Transnacionale Radikale. Nga viti 1994 punoi gazetar në redaksinë e gazetës “Bujku”, pastaj redaktor, zëvendëskryeredaktor, kryeredaktor i gazetës dhe drejtor i “Radio-Rilindjes”. Në vitet 2002-2004 punoi në Kuvendin Komunal të Prishtinës, si përgjegjës për informim dhe komunikim, si dhe zëdhënës i kësaj komune. Nga viti 2005 punon në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, në departamentin për komunikim me publikun. Botoi edhe shkrime në prozë, fejttonistikë dhe publicistikë historike. (Ibrahim Berisha)

BYTYÇI Xhemil (1941-). Mjek, urolog, profesor universiteti. Lindi në Billushë të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Hoçë të Qytetit, kurse të mesmen në Prizren. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Beograd. Fillimisht punoi si mjek në Prizren dhe mësimdhënës në shkollën e mjekësisë në Prizren. Në vitin 1973 kaloi në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializimin nga urologjia e bëri në Spitalin “Rebro” të Zagrebit, ndërsa studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë po në Zagreb. Tezën e doktoratës e mbrojti në vitin 1986 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, më pas mori titujt përkatës, për-

fshirë edhe titullin profesor ordinar për lëndën e kirurgjisë dhe urologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Pas largimit të dhunshëm nga puna në vitin 1990, vazhdoi aktivitetin e tij profesional në klinikën private, pa u shpëputur nga procesi mësimor. Mori pjesë në disa kongrese dhe simpoziume, si dhe botoi një numër punimesh profesionale. (Isuf Dedushaj)

BYTYÇI Ymer (1932-). Gazetar. Lindi në Kërvasaria të Malishevës. Shkollimin fillor e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa Shkollën Normale e mbaroi në Prizren. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në katedrën e albanologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Një kohë punoi në arsim, ndërsa nga vitit 1958 e derisa u pensionua punoi në fillim në Radio Prishtinë, më pas në gazetën “Rilindja” dhe në fund në botimin shqip të gazetës “Komunist”. Në gazetën “Rilindja”, përveç shkrimeve nga fusha e politikës së brendshme, ka shkruar për çështjet e arsimit, të kulturës dhe të letërsisë. Kreu edhe detyrën e redaktorit të kulturës dhe të shefit të korrespondentëve. Më 1979 zgjodhi dhe përgatiti për botim dy vëllime nga krijimtaria e Mihal Gramenos. (Zenun Çelaj)

C

CACAJ-SHUSHKA Gjystina (1938-). Albanologe, profesore universiteti. Lindi në Tuz, ku kreu edhe shkollën fillore. Kreu Normalen e Prishtinës, më pas vijoi studimet për gjuhën angleze, por diplomoi në degën e gjuhës dhe të letërsisë Shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Në vitin 1994 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Universitetin e Tiranës. Punën mësimore e filloi si mësuese në shkollën e Vuksanlekajt (Tuz) dhe e vazhdoi në shkollën “Emin Duraku” në Prishtinë. Në vitin 1980 pranohet lektore për gjuhën e sotme shqipe në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Beogradit, ku punoi 18 vjet. Një vit shkollor (1984/85) qëndroi në Kinë, si eksperte e gjuhës shqipe. U mor edhe me studime nga tradita kulturore dhe arsimore shqiptare. Është autore e disa veprave nga fusha e studimeve albanologjike: “Vepra e Naum Veqilharxhit” (1994), “Gjuha në veprën e Naum Veqilharxhit” (1999), “Gruaja në veprën e At Anton Harapit” (2002) etj. (Palokë Berisha)

CAHANI Irena (1972-). Aktore. Lindi në Mitrovicë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1995). Në vitin 1994 u prezentua para shikuesve si aktore-debutuese me dramën “Kufiri në Atdhe” të T. Dervishit, ndërsa u diplomua me shfaqjen “Këngëtarja tullace” të E. Joneskos. Që nga vitet '90 interpretoi role në shfaqjet e Teatrit “Dodona”, pastaj të Teatrit Kombëtar dhe të Teatrit “Oda”. Në televizion u paraqit me serialin “Kafeneja jonë” në periudhën 2004-2013. Nga viti 2014 interpretoi në filmin televiziv “Stinë dashurie”. Interpretoi edhe një sërë rolesh në filma të shkurtër artistikë. U prezantua edhe në filmin artistik të metrazhit të gjatë

“Tri dritare dhe një varje” të I. Qosjes (2014). (Jeton Budima)

CAKA Masar (1945-2000). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1972). Po aty kreu dhe studimet pasuniversitare. Nga viti 1974 në Akademinë e Arteve Figurative në Prishtinë ligjëroi anatominë plastike, në fillim asistent e më vonë profesor ordinar (1990). Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1976 dhe pjesëmarrës i rregullt në prezantimet e saj. I takonte grupit të piktoreve gjakovarë “Paleta e Dukagjinit”, që u morën me tema të traditës. Nga krijimtaria figurative që përfshin një opus të gjerë, veçohet cikli “Tebdilët” që trajton femrën e mbuluar në dasma për të parë nusen fshehurazi. Ishte kolorist i veçantë, mjeshtër i portretit dhe i figurës. Hapi ekspozita personale në Prishtinë (1970), Beograd (1972), Gjakovë (1983, 1989 dhe 1996) etj. Në Prishtinë në vitin 2002 u hap ekspozita retrospektive (postmortum). Mori pjesë në ekspozitat të përbashkëta në Prizren, Prishtinë, Dubrovnik, Suboticë, Zagreb, Murska Sobotë, Banjallukë, pastaj në Tiranë, Këln, Shtutgart, Hamburg, Paris, Lion, Kozencë, Napoli, Kairo, Damask, Nju-Jork etj. (Tahir Emra)

CAKA Nebi (1946-). Inxhinier i elektroteknikës, gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin bazë, ndërsa studimet për inxhinieri elektrike në fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit i përfundoi në Universitetin e Sarajevës (1971). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1988), disertacionin e mbrojti në Fakultetin



NEBI CAKA

Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (2001). Kreu dhe studimet themelore e pasuniversitare në fushën e gjuhësisë dhe të letërsisë në Fakultetin e Filologjisë të UP-së (1986). Punoi në shkollën teknike “19 Nëntori” në

Prishtinë, më pas në Televizionin e Prishtinës (1973-1990) që nga themelimi i tij dhe drejtor ekzekutiv i buqetës së parë satelitore në gjuhën shqipe “Albanica Sat” (2003-2008). U zgjodh asistent (1976), pastaj ligjërues dhe profesor për lëndët mikroelektronikë dhe optoelektronikë. Ishte i angazhuar si mësimdhënës edhe në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike të Universitetit të Tetovës (1999-2004). Kreu një sërë detyrash me përgjegjësi në Fakultetin Elektro-technik, në organet drejtuese të UP-së dhe mori pjesë në një sërë projektesh shkencore në fushën e informatikës dhe të komunikimit. Është autor i librave “Optoelektronika” (1996) dhe “Fjalësi i lematizuar i revistës ‘Përparimi’ 1-2, 1955” (2013), si dhe bashkautor i librave “Laserët” (2001) dhe “Fjalor i informatikës” (2005). Botoi një sërë punimesh shkencore si autor dhe bashkautor nga fusha e elektronikës, telekomunikimeve dhe laserëve, si dhe nga fusha e gjuhësisë dhe e komunikimit. Është i angazhuar në projektin “Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX” të ASHAK-ut. (Isuf Krasniqi).

CAKIQI Enver (1962-). Mjeshtër i karatesë. Lindi në Llapashticë të Podujevës. Në vitin 1978 filloi veprimtarinë në sportin e arteve marcialë, në klubin e karatesë “Kosovatransi” të Podujevës. Më 1987 fitoi medalje të argjendtë në kampionatin e ish-Jugosllavisë në Prishtinë, në konkurrencën e seniorëve në luftëra. U shpall tri herë kampion i Gjermanisë (në luftëra) dhe dy herë kampion i Gjermanisë në kata Q nga viti 1994 deri më sot është shef-instrukturor i SG-28 e V. Frankfurt-Gjermani. Bartës i titullit Shihan 8 DAN në karate, gjyqtar ndërkombëtar i kategorisë A në karate dhe kik-boks, i licencuar nga federatat përkatëse. Ishte themelues dhe shef-instrukturor në Federatën Shqiptare të Karatesë (1991), themelues dhe instrukturor në SKG “Kosova” të Frankfurtit (1994), themelues i Unionit Mbarëkombëtar Shqiptar të Arteve Marcialë (1996) etj. (Gani Kosumi)

CAKOLLI Femi (1969-). Shkrimtar. Lindi në Mirash të Kamenicës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, gjimnazin në Kamenicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Është themelues dhe pastor i Kishës “Bashkësia Ungjillore e Mesisë” prej vitit 1994. Gjatë viteve 1995-1998 ka qenë vullnetar në Shoqatën e Paraplegjikëve të Kosovës (sot “Handikos”). Është themelues dhe editor i Shtëpisë Botuese “Tenda” në Prishtinë, si dhe themelues dhe kryeredaktor i revistës “Letra e gjallë”. Në vitet 2010-2011 ishte kryetar i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, ndërkaq nga 2013 është bashkëthemelues dhe anëtar i Këshillit Drejtues të “Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante” me seli në Tiranë. Ka botuar vepra nga fusha e kritikës dhe studimeve letrare: “Kodi biblik në letërsinë shqiptare” (2003), “Hiperteksti biblik në letërsinë e Kosovës” (2006), pastaj librin me poezi “Mish fryme” (2008), si dhe një sërë shkrimesh publicistike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. (Adil Olluri)

CAKOLLI Hestet (1957-). Inxhinier, profesor universiteti. Lindi në Krilevë të Kamenicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ferizaj, studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1981). Punoi në Fabrikën “Minex” në Ferizaj. Në vitin 1982 kreu specializimin në Angli. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Shkupit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së. Më 1982 u zgjodh asistent dhe më 2012 arriti titullin profesor i rregullt për lëndët e drejtimit të automjeteve. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh profesionale-shkencore të publikuara në përmbledhje dhe revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Ka bërë një sërë vizitash studimore në vende të ndryshme të Europës. Ishte deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në legjislaturën 2007-2010. (Fehmi Krasniqi)

CAMAJ Fran (1949-). Romancier, publicist. Lindi në Spijë të Tuzit, në Mal të Zi. Kreu shkollimin në Tuz e Prizren, studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Dhjetë vjet punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën fillore të Hotit dhe në shkollën e mesme të Tuzit. Më pastaj

ishite redaktor në programin në gjuhën shqipe në Radiotelevizionin e Malit të Zi (1980-1997). Është autor dhe bashkautor i teksteve shkollore për nxënësit shqiptarë në Mal të Zi. Botoi romanet “Rruga e pamëshirshme” (2004), “Dashuri e dhunuar” (2006), “Mëshira e pamëshirshme” (2008), “Dosja e tmerrit” (2011) dhe “Njeriu me mjekër të thinjur” (2014). Më 2007 botoi përmbledhje me shkrime publicistike e shkencore “Kohët flasin”. (Haxhi Shabani)

CAMAJ Martin (1925-1992). Shkrimtar, gjuhëtar, filolog. Lindi në Temal të Dukagjinit. Ka mësuar në Kolegjin Saverian të Shkodrës (1931-). Nga 1946 ka punuar si mësues në



MARTIN CAMAJ

Malësi deri më 1948, kur është arratisur në Jugosllavi. Më 1949 i ka nisur studimet për romanistikë në Universitetin e Beogradit. Ka bashkëpunuar me Institutin Albanologjik dhe me revistën “Jeta e re” në Prishtinë. Më 1956 është larguar në Itali, e ka përfunduar doktoratën më 1960 në Romë me tezën për “Mesharin” e Buzukut. Më 1961 ka kaluar në Gjermani, pas mbrojtjes së habilitacionit në Universitetin e Munihut më 1964 është zgjedhur docent e më 1971 profesor titullar për albanologji. Në këtë detyrë ka qëndruar deri në pension më 1990. Veprat e para me lirika tradicionale i ka botuar në Prishtinë: “Nji fyell ndër male” (1953) dhe “Kânga e vërrinit” (1954). Në Romë ka vazhduar me “Legjenda” (1957), ndërsa më 1958 ka botuar romanin “Djella”, rrëfim i kombinuar me vjersha. Botimi “Lirikë mes dy moteve” në Munihi ka rimarrë një pjesë të poezive të botuara më parë dhe ka sjellë të tjera me një frymë e dispozicion të ndryshëm në raport me përvojat e mëparme. Më 1978 ka botuar vëllimin e gjerë me lirika “Njeriu më vete dhe me tjerë”. Në këtë frymë e ka rimarrë në “Poezi (1953-1967)” (Munihi 1981) krijimtarinë e tij të mëhershme poetike. Po më 1981 Camaj ka botuar veprën poetike në prozë “Dranja”, që ai e cilësoi madrigale dhe që paraqet një depërtim të ri në raport me krijimtarinë e tij të mëhershme lirike. Po kështu të freskëta në modernitetin e tyre duken poezitë e cikleve “Buell” dhe “Nema” dhe i tërë vëllimi “Palimpsest” (1991). Poezinë e kësaj

periudhe e shquan vargu i lirë me figuracion që synon dhe bën të mundur refleksin dhe vrojtimin, depërtimin në thellësi përhershmërisht të natyrës njerëzore. Poezitë e tij janë përkthyer gjermanisht, anglisht dhe italisht. Me romanin lirik “Djella” Camaj ka manifestuar prirje për prozë. Shquhen romanet “Rrathë” (1978), “Karpa” (1987), prozat “Pishtarët e natës” (1991). Te “Djella” ndeshim një vizion lirik, një rrëfim të poetizuar. “Rrathët” është proza e tij më e gjatë me një sfond psikologjik në rrafshin e jetës së malësisë shqiptare me përshkrime të zakonave, të etnografisë. Në romanin “Karpa”, në prozat “Shkundullima” shpërfaqen shqetësimet e identitetit. Te “Rrathët” gëlon një frazeologji e begatshme dhe shprehje autentike, në veprat e fundit ka tendencë drejt një shprehjeje më të ngjeshur, gjithnjë brenda gegërishtes letrare. Dramat “Loja e mbasadrekes” (1981) dhe “Kandili i argjendit” (1993) kanë tërhequr vëmendjen e kritikës. Në të gjitha fazat e krijimtarisë mbisundon vizioni i vrojtuesit përtej tundimeve të dinamizmit jetësor. Camaj ka bërë jetë aktive prej studiuesi në albanologji. Më 1961 ka botuar studimin “Meshari i Gjon Buzukut”. Më 1966 ka botuar monografinë “Fjalëformimi shqip” (“Albanische Wortbildung”), ndërsa më 1969 “Libër mësimi i gjuhës shqipe”. Ka botuar studime për të folmet e arbëreshëve të Italisë: “E folmja arbëreshe e Greçit të Provincës së Avelinos” (1971), “E folmja arbëreshe e Falconarës Arbëreshe të Provincës së Kozencës” (1977), “E folmja arbëreshe e Shën Konstandinit në Provincën e Potencës” (1993). “Gramatika e shqipes” (Albanian Grammar, 1984), ka një specifikë, që është përpjekja për të paraqitur strukturën e tri varieteteve të shqipes, të shqipes standarde, të gegërishtes letrare dhe të arbërishtes. M. Camaj ka qenë kryeredaktor i revistës “Shëjzat”, ku ka botuar artikuj e recensione për letërsinë. Ka bërë botimin anastatik të veprës së P. Bogdanit më 1977. Gjatë periudhës komuniste në Shqipëri vepra e tij nuk ishte e lejuar. Në Kosovë më vonë njëhej vetëm nga qarqet letrare. Në Prishtinë vepra e tij u botuan në vitet ’90 nga Shtëpia Botuese “Buzuku”. Në Tiranë më 1995 u botua nga A. Klosi vepra në 5 vëllime. Dukagjini në Pejë në vitin 2000 botoi krijimtarinë poetike të M. Camajt, përfshirë variantet e dorëshkrimet me shënime nga R. Ismajli. Vepra e plotë letrare e M. Camajt në 12 vëllime është botuar nga “Onufri” me përgatitje të B. Demirajt më 2011. (Rexhep Ismajli)

CAMI Bardhyl (1934-1993). Mësimdhënës, veprimtar. Lindi në Peshkopi, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e vazhdoi në Normalen e Shkupit. Studioi kimi-biologji në Shkollën e Lartë Pedagogjike po në Shkup. Punoi në shkollën tetëvjeçare, pastaj edhe në gjimnazin e Dibrës si mësimdhënës i kimisë. Punoi, gjithashtu, edhe në shkolla të tjera profesionale, ku u dallua për aftësitë e tij profesionale. Ishte edhe drejtor teknik i fabrikës “Deplast” në Dibër. B. Cami ishte aktiv edhe në jetën politike. (Hatixhe Vojka-Ismajli)

CAMI Medat (1916-1979). Mësues, veteran i arsimit. Lindi në Dibër të Madhe. Pas shkollës fillore në Gjirokastrë, kreu Normalen e Elbasanit. Në periudhën 1941-1945 ishte mësues në Gostivar dhe Tetovë. Për shkak të pjesëmarrjes në LNC, gjatë luftës u burgos. Në vitin 1945 u zgjodh kryetar i Këshillit Komunal të Dibrës, ku vëmendje të veçantë i kushtoi arsimit në gjuhën shqipe. Mori pjesë në organizimin e kurseve për mësues, ishte drejtor i gjimnazit të ulët në Dibër dhe mësimdhënës i disa lëndëve në gjuhën shqipe dhe maqedonase, pastaj inspektor i arsimit në rrethin e Dibrës, përkthyes i teksteve mësimore, këshilltar pedagogjik. Ishte bartës i disa mirënjohjeve dhe dekoratave. (Hatixhe Vojka-Ismajli)

CANA Agim (1956-). Futbollist. Lindi në Gjakovë. Nisi karrierën te “Prishtina”, për të cilën luajti në periudhën 1975-1986. Në vitin 1986 iu bashkua “Dinamos” së Zagrebit, ndërsa më pas shkoi në Turqi, iu bashkua skuadrës turke “Genclerbirligi” (1987/88) e “Samsunspor” (1988/89). E mbylli karrierën në “Montreux Sports” të Zvicrës. Si trajner udhëhoqi tre stinorë ekipin shqiptaro-zviceran “Dardania Lausanne” (1997-2000). Gjithashtu, një kohë ishte edhe menaxher futbollit. Cana i takonte “brezit të artë” të Prishtinës. Dha kontribut në ngritjen sportive dhe profesionale të të birit, Lorik Canës. (Moral Pozhegu)

CANA Lorik (1983-). Futbollist. Lindi në Prishtinë. Me familjen emigroi në Zvicër. Në vitin 1997 iu bashkua një skuadre amatore të krijuar nga shqiptarët e Lozanës. Aty luajti deri në vitin 2000 e më pas firmosi me skuadrën franceze “Paris Saint Germain”. Debutimin me skuadrën e parë e bëri në vitin 2003. Gjatë edicionit 2003/04 luajti 34 ndeshje. Stinorin tjetër Cana luajti 32 ndeshje, ndërkohë kaloi në jug të



LORIK CANA

Në gusht të vitit 2009 Cana debutoi në skuadrën e “Sandërlendit”, duke bërë një paraqitje të shkëlqyer. Në fund të stinorit 2009/10 ishte një nga lojtarët kryesorë të kësaj skuadre. Ai u bë lojtari i parë shqiptar që luan në elitën e futbollit anglez. Më 2010 Cana iu bashkua klubit turk “Galatasaray” (Galatasaray). Qëndrimi i tij në këtë skuadër u pengua nga një dëmtim, kështu që pas një viti u largua nga skuadra turke. Në vitin 2011 Cana firmosi me klubin italian Lazio (Lazio). Ai e përfundoi stinorin e parë me këtë skuadër duke luajtur 15 ndeshje në Serinë A. Gjatë pjesës së dytë të stinorit 2012/13 i luajti të gjitha ndeshjet si titullar, duke e përfunduar edicionin me 24 ndeshje në ligë, 5 ndeshje në Kupën e Italisë dhe 9 në Ligën e Europës. Cana është pjesë e përfaqësueses së Shqipërisë që nga viti 2000, kurse debutimin e tij me kombëtaren e bëri që në moshën 19-vjeçare. (Baki Berisha)

CANA Zekeria (1934-2009). Historian. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Punoi dy vjet si mësues në Irz-niq dhe Deçan dhe njëkohësisht u angazhua si



ZEKERIA CANA

korrespondent i gazetës “Rilindjes” dhe i Radio Prishtinës. Më 1954 u regjistrua në Universitetin e Beogradit, ku u diplomua në degën e historisë. Ishte njëri ndër themeluesit e Shoqërisë studentore “Përpjekja” në Beograd dhe sekretar i parë i saj. Më pas punoi si mësimdhënës i historisë në Gjakovë dhe në Prishtinë. Më 1962 kaloi në Arkivin e Kosovës për t’u larguar që andej për shkaqe politike. Më 1975 në Beograd kreu studimet pasuniversitare, kurse më 1984 në Prishtinë mbrojti disertacionin e doktoratës. Me rithemelimin e Institutit Albanologjik më 1967 u pranua si asistent në degën e historisë. Në këtë institut për një kohë kreu detyrën e

sekretarit shkencor, si dhe të sekretarit të Bashkësisë Krahinore të Punës Shkencore. Z.Cana është autor i monografive: “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912” (1979); “Shpalime historike” (1983); “Dimitrije Tucoviq - koha dhe vepra” (1983); “Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914” (1986); “Populli Shqiptar në kapërcyell të shek.XX” (1990); “Shpalime historike II” (1998); “Ditari i luftës” (1999). U mor edhe me përkthime nga gjuha serbokroate dhe ruse, me publicistikë, eseistike dhe kritikë historiografike. Botoi shumë artikuj studimorë në revista shkencore dhe mori pjesë në shumë aktivitete shkencore me referate dhe kumtesa në simpoziume dhe konferenca shkencore në Kosovë e jashtë saj. Krahas punës kërkimore-shkencore Z.Cana zhvilloi veprimtari të dendur si aktivist politik i të drejtave të njeriut. Ishte bashkautor i “Apelit 215” të intelektualëve shqiptarë, themelues i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë (1989), nismëtar i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve dhe bashkëveprimtar i prof. Anton Çettës. (Jusuf Bajraktari).

CANAJ Avdush (1955-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Koretin. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Gjilan, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Punoi si gazetar në emisionet për fëmijë të Televizionit të Prishtinës. Në ushtri u dënua me pesë vjet burg për shkaqe politike. Pas daljes nga burgu mbeti shumë vjet pa punë. Nga viti 1997 punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në Gjilan, kurse tash përgatit emisionet për fëmijë në Televizionin e Kosovës. Shkruan poezi dhe tregime për fëmijë. Në këtë fushë paraqet një zë të veçantë për shkak të temës më të shpeshtë të trajtuar në krijimtarinë e tij: marrëdhëniet e ndërsjella të fëmijëve, përkatësisht simpatia e parë, e cila jepet në mënyrë të lehtë, nëpërmjet situatave nga jeta e përditshme, me një ndjeshmëri dhe gjuhë adekuate dhe me një shprehje të kursyer. Mori çmimet letrare për librin më të mirë të vitit të revistës “Pionieri” dhe çmimin “Ymer Elshani”. Veprat e botuara: “Gjenerali me epoleta” (1993), “Lepurushi i çokollatave” (1994), “Gonxhja nga Jupiteri” (2000), “Zogu në derë” (2003), “A fle peshku me pizhame” (2008) etj. (Arif Demolli)

CANAJ Fejzullah (1924-2007). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Mësimet e para i mori në vendlind-

je dhe më pas në Medresenë e Shkupit. Në Prishtinë ndoqi mësimet në gjimnazin “Sami Frashëri”. Pas Luftës së Dytë Botërore u angazhua mësues dhe pastaj caktohet kryeredaktor i gazetës “Zani i rinisë shqiptare” (1947/48). Më 1952 bëhet redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën “Rilindja”. Në prag të nisjes së daljes së “Rilindjes” gazetë e përditshme, më 1958 caktohet shef për korrespondentë. Këtë detyrë e ushtroi deri më 1965, kur kalon në Radio Prishtinë, ku punon derisa u pensionua, më 1985. Ishte gazetar i parë shqiptar në Kosovë, që u nxor para gjyqit për shkak të një shkrimi në “Rilindje” (më 1952) rreth keqpërdorimit të religjionit diku në një fshat të Rahovecit. (Zënnun Çelaj)

CANI Bahri (1966-). Gazetar. Lindi në Baincë të komunës së Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në Baincë dhe Shalë, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Në Beograd kreu Fakultetin e Shkencave Politike (1990) dhe më pas studimet pasuniversitare. Gazetarinë e filloi në gazetën “Borba” të Beogradit në vitin 1992. Nga viti 1994 nis bashkëpunimin e rregullt me radion gjermane “Deutsche Welle”, si korrespondent nga Beogradi. Gjatë luftës së Kosovës u arrestua, por u lirua shpejt në mungesë provash. Pas luftës shkoi në Gjermani, në Radion “Deutsche Welle”, ku punoi si redaktor në radio, internet dhe televizion. B. Cani është bashkautor i librit “Kosmet ose Kosovo” (Kosmet ili Kosovo), i broshurave “Kush po e ndan Kosovën”, “Quo Vadis Kosovo” etj. Mori pjesë në shumë konferenca dhe seminare për Kosovën dhe Europën Juglindore në Gjermani, Shqipëri, Kosovë, Hungari, Serbi etj. (Rahman Paçarizi)

CANOLLI Basri (1976-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Marec të Prishtinës. Në vitet 1997, së bashku me vëllezërit shkoi në Malit të Zi, ku arriti të sigurojë armatim për nevoja të UÇK-së. Po në këtë vit iu bashkua njësiteve të UÇK-së, ku iu ngarkuan detyra ushtarake në zonat operative të Llapit dhe Karadakut. Në qershor 1998 kaloi në Zonën Operative të Drenicës dhe pastaj në Zonën e Karadakut, ku u caktua në njësitin pararojë të komandantit të Brigadës 153. Më 16 qershor mori pjesë në mbrojtjen e popullatës civile në fshatrat e Kamenicës, që sulmoheshin nga

bandat serbe. Më 18 qershor 1999 ra në një përballje të drejtpërdrejtë me forcat serbe në fshatin Lashtar të Kamenicës. Në vitin 2012 u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Bedri Muhadri)

CANOLLI Burim (1983). Skulptor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2006). Më 2009 ishte laureat i ekspozitës “Rruga e kombit - profili i një ëndrrë” nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë. Më 2010 ishte fitues i çmimit të ekspozitës “Jeta dhe vepra e Nënës Terezë”, organizuar nga Galeria e Arteve e Kosovës. Më 2012 fitoi çmimin e projektit “Kulturë për të gjithë”. Më 2009 ka hapur ekspozitën personale në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, ndërsa ka marrë pjesë në ekspozita kolektive në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, në ekspozitën e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, në Muzeun e Kosovës, në Galerinë “Çifte Hamam” në Shkup, në Galerinë e Arteve në Tiranë etj. Veprat e tij shquhen për nga shprehja ekspresive-abstrakte. (Agim Rudi)

CANOLLI Florim (1986-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studio për gazetari dhe komunikim masiv. Punën e gazetarit të sportit e nisi në vitin 2009 në gazetën e përditshme sportive “Sport”, ku punoi deri në nëntor të vitit 2012. Gjatë vitit 2011 ishte edhe redaktor i sportit në televizionin “Top Kosova”. Nga viti 2012 është gazetar dhe komentator në televizionin “Super sport Kosova”. (Florim Maliqaj)

CANOLLI Rabie (1982-). Poete. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje, studimet për stomatologji në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Si nxënëse e shkollës fillore ka nisur të shkruajë dhe të botojë vjersha për të rritur. Si nxënëse ka botuar katër vëllime me poezi, duke vazhduar me botime edhe në periudhën vijuese: “Buzagaz me helm” (1995), “Dua të kënaqem duke qeshur” (1996), “Miti i ëndrrës” (1997), “Pas mitit” (1999). Jeton në Zvicër. (Hasan Hasani)

CARA Dervish (?-rreth viteve '60 të shek. XIX). Udhëheqës kryesor i kryengritjes antiosmane të viteve 1843-1844. Lindi në Pallçisht të Tetovës në fund të shek. XVIII. Mori

pjesë në një varg kryengritjesh antiosmane. Si udhëheqësi kryesor i kryengritjes, u zu rob më 19 maj 1844 nga trupat e Osman Pashë Llatasit në Betejën e Katllanovës. Më pas u dërgua në burgun e Selanikut. Në fund të vitit 1844, në Stamboll, u organizua një proces gjyqësor, ku i akuzuari kryesor ishte Dervish Cara, i cili kishte marrë mbi vete të gjithë përgjegjësinë e kryengritjes. U dënua me vdekje, por më pas dënimi u zëvendësua me burg të përjetshëm. Rreth fundit të jetës së D. Carës nuk dihet gjë. Thuhet se ka vdekur në Stamboll rreth viteve '60 të shek. XIX. Sipas diplomatit anglez Lejard, i cili e kishte takuar personalisht D. Carën, organet osmane të ndjekjes kishin ushtruar dhunë dhe e kishin torturuar atë bashkë me shumë drejtues dhe pjesëmarrës të kryengritjeve antiosmane. Ka të ngjarë të ketë vdekur nga torturat e burgut. (Nebi Dervishi)

CARA Indrit (1971-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Kavajë. Kreu shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë dhe vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë për artiljer kundërajror. Me fillimin e proceseve demokratike në Shqipëri, I. Cara emigroi në Itali, ku qëndroi dy vjet. Më pas kaloi në Londër, ku u njoh dhe punoi me shumë emigrantë nga Kosova. Në janarin e vitit 1999 vendosi të largohet nga Britania e Madhe dhe t'u bashkohet formacioneve të UÇK-së në Kosovë. Në fillim të muajit mars 1999 arriti të futet në Kosovë. U caktua komandant i kompanisë autonome të Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë të Drenicës. Më 31 mars të vitit 1999 u përfshi në luftime në Zonën Operative të Pashtrikut, me qëllim të mbrojtjes së popullsisë së rajonit të Pagarushës. Komanda e Zonës Operative të Pashtrikut kishte kërkuar përforcime nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Shtabi urdhëroi kompaninë autonome të komanduar nga I. Cara të bëjë veprimet e nevojshme luftarake në ndihmë kësaj zone. Gjatë këtyre luftimeve u vra I. Cara nga një predhë artilerie. U nderua me shumë mirënjohje në Shqipëri dhe në Kosovë. (Dilaver Goxhaj)

CARABREGU Muharrem (1945-2017). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa shkollimin e lartë në Prishtinë (1968). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Zagreb,



MUHARREM
CARABREGU

ku edhe doktoroi në fushën e hartografisë (1975). Më 1970 filloi punë në degën e gjeografisë të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëroi për shumë vite lëndët hartografi, gjeografi matematike etj. Dy herë qendroi në SHBA me që-

llim specializimi nga fusha e hartografisë dhe e aerokozmofotointerpretimit. Mori pjesë aktive në konferenca shkencore dhe profesionale me punime dhe kumtesa të ndryshme. Botoi shumë studime, artikuj dhe disa tekste universitare nga fusha e hartografisë dhe gjeografisë shoqërore, si: “Kosova në hartat e vjetra” (1977), si dhe tekstet universitare: “Hartografia” (1978) dhe “Aerokozmofotointerpretimi” (1983), pastaj “Gjeo dhe hartolinguistika” (1990) etj. (Shpejtim Bulliqi)

CARALLUKA. Fshat në komunën e Malishevës, 5 km në verilindje të saj. Shtrihet në lartësi mesatare mbidetare 550 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe 987 ha. Si vendbanim me emrin Cirnelug përmendet në defterin e sanxhakut të Prizrenit (1530). Në vitin 2011 Caralluka kishte 2,226 banorë, ndaj 601 banorë në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori, ndërsa një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave i sigurojnë nga remitancat prej botës së jashtme. (Ferim Gashi)

CARIÇIN GRAD. Qytet i antikës së vonë në Dardani. Gjendet rrëzë bjeshkës së Radanit te Lebane, 30 km larg Leskovcit (Serbi, rreth 10 h). Gërmimet arkeologjike u realizuan ndërmjet viteve 1912-1976 dhe u konstatua ekzistimi i një vendbanimi të urbanizuar të fillimit të shek. VI. Qyteti kishte mure fortifikuese me kulla, porta, rrugë, pallate me mozaikë e freska, ujësjellës, kanalizime dhe kapitule shtyllash që mbajnë monogramin e perandorit. Përmes ledheve qyteti ndahej në atë të epërm dhe të poshtëm, ndërsa në pjesën më të epërme gjendej akropoli, qendër e parisë kishtare. Aty gjendej dhe sheshi rrethor, ku zhvillohej jeta publike. Janë zbuluar disa kisha, ndërsa përmes analizave gjeoradarike (2015) janë konstatuar dhe katër të reja. Kronologjia e qytetit korrespondon me kohën e themelimit të Justinianës së Parë

dhe kjo e bën më të pranueshme hipotezën e lokalizimit të tij në Cariçin Grad sesa në arealin e Shkupit. Është nën mbrojtjen e UNESCO-s. (Emine Kalaja-Hajdari)

CARRALEVA. Fshat në komunën e Shtimes, rreth 7 km në perëndim të qytezës. Shtrihet përgjatë lumit dhe rrëzë maleve të Carralevës, pranë rrugës magjistrale Shtime-Prizren dhe Shtime-Komorani. Sipërfaqja e fshatit është 10.8 km². Për herë të parë në dokumentet e shkruara është përmendur në vitin 1348 dhe 1455, pastaj në defterin e sanxhakut të Shkodrës (1458) dhe defterin e sanxhakut të Vushtrrisë më 1566. Më 8 maj të vitit 1910 në grykën e Carralevës u zhvillua beteja ndërmjet forcave kryengritëse shqiptare në krye me Isa Boletinin dhe forcave turke të udhëhequra nga Xhafer Beu e Shefqet Dërgut pasha. Në vitin 1948 kishte 616 banorë, ndërsa në vitin 2011 numëron 1,146 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori, me eksploatimin e gurëve për ndërtimtari etj. Carraleva është seli e bashkësisë lokale, ka shkollën 9- vjeçare, stacionin shëndetësor etj. (Shpend Agaj)

CELINA Durmish (1916-1994). Mjek, specialist i preventivës. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Studimet i filloi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, por u diplomua në Zagreb në vitin 1942. Fillimisht punoi si mjek në spitalin e Prizrenit, në vitin 1944 u burgos dhe u internua në kampin e Prishtinës. Në periudhën 1944-1946 ishte mjek në Suharekë dhe Rahovec dhe më pas u caktua mjek i rrethit të Prizrenit dhe të Prishtinës. Në Prishtinë u emërua drejtor i shkollës së ulët të porsahapur të mjekësisë, ku punoi deri në vitin 1948. Deri në vitin 1951 ishte drejtor i shkollave të medicinës dhe udhëheqës i internateve të tyre në Pejë dhe Mitrovicë. Në periudhën 1951-1965 ishte udhëheqës i Stacionit Epidemiologjik-Higjienik dhe më vonë i Entit Higjienik dhe i shërbimit higjienik-epidemiologjik në Qendrën Mjekësore në Prizren, ku punoi derisa u pensionua (1978). Mbahet mend për faktin se në vitin 1972 ishte i pari në ish-Jugosllavi që caktoi saktë diagnozën e variolës. Bëri shkrime për mbledhjen, përgatitjen dhe përdorimin e bimëve mjekuese dhe dha kontribut për zhvillimin e fabrikës së prodhimeve farmaceutike “Farmakos” në Prizren. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Isme Humolli)

CELULAT E PARA SOCIALISTE (KOMUNISTE) NË KOSOVË. Pas Kongresit themelues të Partisë Socialiste Punëtore të Jugosllavisë (komuniste) në Beograd, të gjitha organizatat socialiste në Kosovë u shndërruan në organizata të Partisë Socialiste Punëtore të Jugosllavisë, kurse pas Kongresit të Vukovarit në organizata të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Deri te shpallja e “Obznanës”, këto organizata kanë qenë mjaft të gjera dhe të lidhura me Sekretariatit Krahinor të PKJ-së në Shkup, i cili udhëhoqi punën në territorin e Maqedonisë, të Kosovës dhe të Serbisë Jugore. Veprimtaria e komunistëve deri në aprovimin e “Obznanës” dhe të Ligjit mbi mbrojtjen e shtetit zhvillohej në propagandimin e ideve socialiste, organizimin e manifestimeve, grevave të punëtorëve etj. Organizatorët e lëvizjes komuniste në Kosovë ishin Ilija Krasojeviq, Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, Zef Lush Marku etj. Pas “Obznanës” (1929) policia bëri arrestime në masë të komunistëve, u bënë bastisje në shtëpitë e komunistëve dhe mbylli lokalet e partisë. Pas këtyre zhvillimeve, komunistët e ndërprejnë punën për një periudhë dhe kaluan në ilegalitet. Një pjesë e tyre u larguan nga PKJ-ja dhe hynë në radhët e partive të tjera. (Ilir Zylfiu).

CENA Hilmi (1941-). Veterinar, profesor universiteti. Lindi në Rahovec, shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen bujqësore në Sombor, Fakultetin e Bujqësisë, seksionin e blegtorisë, në Universitetin e Beogradit (1965). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Veterinarisë të Universitetit të Zagrebit (1972), ku mbrojti edhe tezën e disertacionin të doktoratës. Një kohë punoi në gjimnazin e Rahovecit dhe më pas zgjidhet mësimdhënës në Shkollën e Lartë Bujqësore për lëndën e anatomisë dhe fiziologjisë së kafshëve shtëpiake. Në vitin 1972 zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës, ku më pas i merr edhe titujt e tjerë universitarë. Ka botuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale në vend dhe në botën e jashtme. (Xhevat Domi)

CENA Sabahajdin (1953-). Mbledhës i folklorit, studiues dhe mësimdhënës universitar. Lindi në Rahovec. Mbaroi studimet në degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe

mbrojti disertacionin e doktoratës nga letërsia popullore. Ka marrë pjesë me kumtesa në tubime të ndryshme shkencore dhe ka botuar një sërë artikujsh studimorë nga fusha e folklorit dhe e etnologjisë. Është bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe në botimet e tij janë përfshirë materiale të ndryshme nga terreni: balada, legjenda, këngë të kreshnikëve, këngë epike historike, këngë lirike, anekdota, kallëzime popullore etj. Në Fakultetin e Edukimit në Prizren ligjëron lëndët letërsi popullore dhe letërsi e vjetër shqipe. Është bashkautor i vëllimeve V-XVI të botimit “Feniksët e lirisë” (2004-2014). (Zymer U. Neziri)

CENAJ Ali (1957-). Gazetar. Lindi në Kravar të Ulqinit. Shkollimin fillor e kreu në Katerkollë, të mesmin në Ulqin, ndërsa studimet për letërsi në Prishtinë. Në vitet 1984-1990 punoi përkthyes në gazetën “Komunisti”, botim për Kosovën, pastaj nga viti 1990 në gazetën “Rilindja”, si gazetar në sektorë të ndryshëm. Ndërkohë, u mor me tema e projekte të gazetarisë hulumtuese. Nga viti 2000 punoi në gazetën “Zëri”, i angazhuar gjithashtu në tema hulumtuese, kryesisht nga sektori i sigurisë dhe proceset gjyqësore për krimet e luftës. (Ibrahim Berisha)

CENTRALIZIMI-DECENTRALIZIMI I ARSIMIT. Me legjislacionin shkollor të Republikës së Kosovës, sistemi i arsimit është pjesërisht i centralizuar, pjesërisht i decentralizuar. Institucionet qendrore shtetërore (Kuvendi, Qeveria, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë) janë bartës, përgjegjës dhe kompetentë për çështje kryesore të përgjithshme të arsimit, siç janë: politikat arsimore, hartimi dhe miratimi i legjislacionit arsimor dhe implementimi i tij, cilësia dhe efikasiteti i arsimit, certifikimi i mësimdhënësve, baza materiale-financiare e arsimit etj. Me legjislacionin në fuqi shumë kompetenca dhe përgjegjësi në fushën e arsimit u kalojnë komunave, për aq sa ato i përkasin interesit lokal, gjithnjë në respekt të standardeve të përcaktuara me ligj. Komunitat kanë kompetenca në arsimin parauniversitar: parashkollor, fillor dhe të mesëm (të ulët dhe të lartë). Komuna e Mitrovicës Veriore ka kompetenca të zgjeruara në fushën e arsimit. Decentralizimi shtrihet edhe në institucione

arsimore parauniversitare dhe universitare. (Riza Brada)

CERAJA Jakup (1937-2001). Shkrimtar, publicist. Lindi në Cerajë të Mitrovicës. Kreu shkollimin fillor në Mitrovicë, ndërsa në Prishtinë vazhdoi studimet për gjuhë shqipe dhe letërsi. Në fillim punoi si mësues në vendlindje, pastaj mësimpldhënës i gjuhës shqipe në Mitrovicë. Së fundi ishte këshilltar pedagogjik për gjuhë shqipe në Entin Pedagogjik në Mitrovicë. Është autor i një sërë përmbledhjesh poetike për fëmijë dhe të rritur dhe i shkrimeve publicistike. Disa nga veprat e botuara janë: “Përkushtime” (1966), “Pranvera po të bëhet verë” (1971), “Ngjarje që s’duan shpjegime” (1973), “As duket as humbet” (1980), “Udhëton me erëra” (1985), “Fund me diell” (1990), “Kalliri mendjemadh” (2001), “Diellori” (2004), “101 pikëpyetje - gjëgjëza për fëmijë” III (2007), “Lepurushi trimosh” (2010), “Pikla vese në bebëza”, (2010). Ishte autor i angazhuar në jetën politike, i ndjekur dhe i burgosur nga regjimi jugosllav. Edhe krijimtaria e tij ishte e lidhur ngushtë me përkushtimet e tij kombëtare. (Kujtim Rrahmani)



JAKUP CERAJA

CËRNICA Ramiz (1903-1979). Veprimtar politik para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Cërnica të Gjilanit. Në vitet ‘30 dy mandate ishte kryetar i komunës së Parteshit. Kundërshtoi reformën agrare dhe shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Për këtë arsye u burgos disa herë nga pushteti serb. Pas kapitullimit të Jugosllavisë më 1941 dhe pas ndarjes së zonave pushtuese, mori pjesë në shumë aksione kundër dhunës që ushtronte pushtuesi bullgar mbi popullsinë shqiptare. Me bashkimin e një pjese të Kosovës me Shqipërinë, R.Cërnica u zgjodh sërish kryetar i komunës së Parteshit. Së bashku me Rifat Berishën dhe Hasan Remnikun shpëtoi Aradhen partizane “Emin Duraku” nga forcat italiane



RAMIZ CËRNICA

dhe vullnetare më 26 prill 1943 në Livoç të Gjilanit. Nga shtatori dhe deri në nëntor të vitit 1944 u angazhua në operacionet për mbrojtjen e Kosovës Verilindore nga sulmet e njësiteve partizane serbe, bullgare dhe maqedone. Si përfaqësues i Gjilanit mori pjesë si delegat në mbledhjen e Kuvendit të Prizrenit (8-10 korrik 1945), ku kundërshtoi vendimin që Kosova t’i bashkohet Serbisë. Për këtë qëndrim u dënua më 20 vjet burg. Edhe pas vuajtjes së dënimit ishte aktiv në ndjekjen e rrjedhave shoqërore të kohës. (Fehmi Rexhepi)

CIKLET E KËNGËVE HISTORIKE. Grupe këngësh, në të cilat trajtohet një ngjarje e rëndësishme historike ose tërësia e veprimeve luftarake të një heroi. Ndonëse ka disa gjurmë të këngëve për periudhën bizantine, cikli më i vjetër i këngëve historike shqiptare i kushtohet Luftës së Kosovës të vitit 1389. Një cikël të këtillë krijojnë edhe këngët që i kushtohen periudhës së Skënderbeut, pastaj ato të sundimit osman në viset shqiptare, si edhe luftërave për autonomi të Ali pashë Tepelenës dhe ato të Bushatlinjve të Shkodrës. Në folkloristikën shqiptare cikël të veçantë formojnë edhe këngët e kryengritjeve kundër Reformave të Tanzimatit për trimat e njohur, si: Rrapo Hekali, Celu Picari, Fezo Xhafua, Ali Binaku e të tjerë. Këngët e periudhës së Rilindjes Kombëtare, sidomos ato për ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mund të konsiderohen si cikël i madh, brenda të cilit janë përfshirë edhe ciklet e veçanta për muhaxhirët, për luftërat kundër ushtrive pushtuese malaziase në Plavë e Guci, në Hot e Grudë e në Ulqin, për trimat si Mic Sokoli, Ali pashë Gucia, baladat për Hysen Smajlin, për luftën e kundër Maxhar Pashës në Gjakovë etj. Cikle të veçanta të këngëve historike janë krijuar edhe për kryengritjet në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, si edhe për personat e dalluar të kësaj periudhe, si: Isa Boletini, Bajram Curri, Ismail Qemali, Idriz Seferi etj. Një cikël të veçantë përbëjnë këngët e kaçakëve, të cilët ngritën krye pas pushtimit serb të Kosovës, siç janë: këngët për Azem Bejtën, Mehmet Delinë, Qorr Ilazin, Sali Shabanin dhe trimat e shumtë të viseve të Rugovës, si Jashar Haxha, Ker Sadria e të tjerë. Cikël të veçantë bëjnë edhe këngët historike kundër kolonizimit të viseve shqiptare dhe kundër shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve të Kosovës për në

Turqi, siç janë: këngët për Rrahman Dedinë, Ramë Bllacën, Nazim Gafurrin, Ahmet Shtimjen e të tjerë. Janë krijuar edhe shumë këngë që paraqesin shtypjen e shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste. Edhe sot kënga jonë historike e ka të hapur periudhën prodhuese. Dëshmi për këtë janë këngët për trimat e UÇK-së, si një cikël i veçantë në kuadër të këngëve historike, që i kushtohen Adem Jasharit, Fehmi Lladrovci, Tahir Sinanit, Mujë Krasniqit, Zahir Pajazitit etj. (Adem Zejnullahu)

CIKLI I KËNGËVE TË GJERGJ ELEZ ALISË.

Janë këngë që i kushtohen heroit të plagosur me nëntë plagë në trup, Gjergj Elez Alisë, i cili ngrihet nga shtrati dhe del në dyluftim me bajlozin për të mbrojtur nderin familjar dhe interesin popullor. Cikli shtrihet në të gjitha viset e këngëve shqiptare epike legjendare. Motivi i Gjergj Elez Alisë, apo i heroit me nëntë plagë në trup, gjendet edhe në traditën epike të popujve të tjerë të Ballkanit dhe, si i tillë, lidhet me këngët me karakter mitik-fetar të luftës së Shën Gjergjit kundër kuçedrës. Emrin e ngjashëm të heroit e hasim edhe në folklorin e myslimanëve të Bosnjës, por atje ka karakteristika krejtësisht të tjera, madje edhe përbërës humoristikë. Këngët shqiptare për Gjergj Elez Alinë kanë edhe një bazë të caktuar historike, që lidhet me emrin e bajlozit nga *bailo* ose *baiulus*, siç quheshin sundimtarët e normanëve, të cilët patën pushtuar dikur Shqipërinë. Në viset periferike shqiptare, siç është Kosova Veriore (Shala e Bajgorës), mund të gjendet edhe ndonjë variant që ka elemente të ngjashme me këngët e myslimanëve të Bosnjës. Por cikli i këngëve shqiptare për Gjergj Elez Alinë shquhet për origjinalitetin dhe vlerat e larta artistike. Figura e këtij heroit në memorien kolektive të shqiptarëve është shndërruar në simbolin e qëndresës së popullit në luftë kundër dhunës së të huajve. (Sadri Fetiu)

CIMILI Ramadan (1951-). Futbollist, trajner. Lindi në Vushtrri. Nisi karrierën e futbollistit në skuadrën KF "Radniçki" më 1968. Pas një viti kaloi në radhët e "Trepçës", kurse në edicionin 1972/73 ishte pjesë e KF "Buduqnosti" të Pejës, ku edhe u shpall shënuesi më i mirë në kampionatin e Kosovës. Më pas kalon në KF "KEK-u" dhe KF "Liria", kurse në edicionin 1977/78 kthehet në KF "Trepça", me të cilën

luan në finale të Kupës së Jugosllavisë. Në vitin 1980 kalon në KF "Prishtina" ku me "brezin e artë" në edicionin 1982/83 arriti të inkuadrohet në Ligën e parë të Jugosllavisë. Kampionati 1987/88, ishte i fundit për Cimilin si futbollist aktiv. Në vitet 1988-1991 në Sarajevë vijoi shkollën e lartë për trajner të futbollit. Në vitin 1993 shkon në Zvicër, ku qëndroi deri në vitin 2000, duke qenë trajner i disa skuadrave. Pas kthimit në Kosovë, bëhet pjesë e KF "Drenica", më vonë e KF "Ferizaj" dhe KF "Drita" të Gjilanit, me të cilën bëhet kampion i Kosovës. U kthye sërish në Zvicër dhe më 2008 në Prishtinë, ku vazhdon punën me grupmoshat e reja në shkollën e futbollit të Prishtinës. (Baki Berisha)

COKA Halit (1974-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Arrën të Kuksit. Pasi mbaroi shkollën e mesme në Shkodër, emigroi në Greqi. Në janar të viti 1999 u paraqit në qendrën stërvitore të UÇK-së në Helshan të Krumës. Pas disa ditësh stërvitjeje u inkuadrua në Brigadës 134 "Blerim Shala", që vepronte në rajonin e Deçanit dhe të Junikut. Në fillim të muajit prill 1999 ushtria serbe ndërmoi një ofensivë të fuqishme për asgjësimin e forcave të Zonës Operative "Dukagjini" të UÇK-së. H. Coka u vra gjatë luftimeve në fillim të muajit prill 1999. Shkolla 9-vjeçare në Bathore të Tiranës mban emrin e tij. (Dilaver Goxhaj)

CORROTICA. Vendbanim rural i tipit të dendur në Luginën e Preshevës, rreth 7 kilometra në veri të Preshevës. Shtrihet në kontaktin e shpateve të ulëta të Karadakut në perëndim me fushën e Preshevës në lindje (447 m), në të dyja anët e rrugës rajonale Miratoc-Lluçan. Sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2002 fshati ka pasur 2, 230 banorë, nga të cilët një e treta punojnë në botën e jashtme. Është qendër e bashkësisë lokale edhe për fshatrat Bukuroc dhe Shoshajë e Poshtme. Popullsia merret me bujqësi, ndërsa shumë familje mbahen nga remitancat. Fshati ka shkollën 8-vjeçare, stacionin shëndetësor dhe disa njësi tregtare. Nga një vendbanim i dendur i tipit rrethor, Corrotica gjithnjë e më shumë po merr formën e vendbanimit të zgjatur, për shkak të ndërtimit të objekteve të banimit në të dy anët e rrugës që e përshkon fshatin, duke u bashkuar edhe me Shoshajën e Poshtme. (Arsim Ejupi)

CUFAJ Beqë (1970-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Gramaçel të Deçanit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Deçan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin



BEQË CUFAJ

e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punoi në gazetën e përditshme “Koha ditore” dhe “Zëri”, si dhe shkroi tekste për gazetën gjermane dhe zvicerane, si “Frankfurter Allgemeine Zeitung” e “Neue Zürcher Zeitung”. Është njëri nga drejtuesit e portalit informativ prishtinas “Blic”. Ka hyrë në botën e letrave artistike me vëllimin poetik “Baladë budallaqe” (1994), për të vazhduar me librin me tregime “205” (1996), pastaj me romanet “Shkëlqimi i huaj” (2003) dhe “Projekt@party” (2012) dhe librat publicistikë “Kosova” (ese dhe reportazhe nga lufta e Kosovës, në gjermanisht, 2000), “Laboratori i lirisë, nga ditari 1999-2009” (2011). Eshtë, tregimet dhe romanet e tij janë botuar në gjuhë të ndryshme. Ka marrë një sërë çmimesh ndërkombëtare, nga të cilët edhe çmimin “Autori i vitit 2012” për romanin “Projekt@party”, nga Klubi Ekonomik në Shtëpinë e Letërsisë të Shtutgartit. (Adil Olluri)

CULAJ Lush (1966-). Historian-këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Lindi në Klinë. Kreu studimet e larta për histori në Universitetin e Prishtinës (1990), më pas studimet pasuniversitare, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Institutin Albanologjik të Prishtinës në vitin 2001. Në periudhën 2002-2013 ishte shef i degës së historisë në Institutin Albanologjik. Ka botuar disa monografi historike dhe vepra studimore: “Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924” (1997), “Zef Gjidoda, jeta dhe veprimtaria atdhetare” (2002), “Shqipëria dhe çështja kombëtare 1918-1928” (2004), “Shqiptarët në gjysmën e parë të shek. XX” (2005), “Shqipëria dhe çështja e Çamërisë 1912-1939” (2008); “Ker Sadria, jeta dhe veprimtaria atdhetare” (2008), “Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit 1919-1920” (2010) etj. Ka botuar edhe një varg artikujsh në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Sulltane Ukaj)

CURAJ Nazire (1946-). Mësimdhënëse atdhetare. Lindi në Ostros të Vogël (Krajë). Pas arsimit fillor në vendlindje, arsimin e mesëm e mori në Normalen e Ferizajt. Filloi të punojë si mësuese në vendlindje (1966). Ishte mësuesja e parë e Krajës. U shqua për veprimtari politike. Disa herë kaloi ilegalisht dhe qëndroi në Shqipëri, ishte pjesëmarrëse dhe organizatore e demonstratave në Ferizaj (1981), formoi dhe drejtoi grupin ilegal “Jehona e Krajës”, shkroi dhe shpërndau materiale propagandistike. U arrestua dhe u torturua disa herë dhe vuajti shumë vjet në burgjet e Ferizajt, Nishit, Mitrovicës, Prishtinës dhe të Beogradit. Jetoj me tri vajzat e saj në vuajtje dhe në varfëri. Rifilloi punën si mësimdhënëse në Ferizaj (1992). (Hajrullah Koliqi)

CURRI Bajram (1862-1925). Veprimtar politik dhe ushtarak, njëri ndër udhëheqësit kryesor i kryengritjeve antiosmane dhe i luftës për çlirim kombëtar. Lindi në Krushë të Madhe.



BAJRAM CURRI

Që në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e më pas në vitet ‘80-‘90 të shekullit XIX udhëhoqi çetat kryengritëse në Kosovë kundër pushtuesve osmanë. Për një kohë ishte komandant i xhandarmërisë në vilajetin e Kosovës. Njëri ndër organizatorët e Lidhjes së Pejës (1899-1900), së bashku me Haxhi Zekën dhe bashkëpunëtorin kryesor i tij, për mbrojtjen e tërësisë territoriale të trojeve shqiptare. Ishte njëri nga prijësit e lëvizjes antiosmane në Kosovë në kryengritjet e vitit 1908 dhe udhëheqës i Kuvendit të Ferizajt (korrik, 1908), duke u rreshtuar në anën e atyre që kërkuan shpalljen e Kushtetutës nga Sulltani. Përkrahu dhe ndihmoi thirrjen e Kongresit të Manastirit (1908), duke mbrojtur edhe alfabetin e gjuhës shqipe që u miratua në Manastir. Ndihmoi themelimin e klubeve dhe të shkollave shqipe në Kosovë dhe më gjërë. Ishte nënkryetar i klubit “Bashkimi” të Shkupit nga viti 1908. U shqua në udhëheqjen dhe organizimin e luftimeve që u zhvilluan në Kosovë gjatë kryengritjes së vitit 1910 në Qafë të Morinës, ashtu si edhe gjatë kryengritjes së përgjithshme antiosmane më 1912. Në maj të vitit 1912, pas vendimeve të Kuvendit të Junikut u angazhua me forcat e veta si komandant dhe si strateg

popullor në kryengritjen e përgjithshme, duke thyer forcat osmane në Qafë të Prushit dhe në zonën e Rrafshit të Dukagjinit. Në gusht të vitit 1912, së bashku me Idriz Seferin, Hasan Prishtinën, Isa Boletinin e prijës të tjerë, pasi kishin çliruar pjesën më të madhe të Kosovës, hynë në kryeqytetin e vilajetit në Shkup, të cilin e çliruan nga forcat osmane. Ishte ndër organizatorët e rezistencës kundër forcave serbo-malazeze, të cilat sulmuan Kosovës gjatë luftërave ballkanike. Kundërshtoi vendimet e Konferencës së Londrës më 1913. Më pas ishte njëri ndër organizatorët e kryengritjes antiserbe në shtator të vitit 1913, për çlirimin e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare nga sundimi serbo-malazez dhe për bashkimin e tyre me shtetin amë. Me rastin e themelimit të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” më 1918 ishte njëri ndër udhëheqësit kryesorë të tij, duke përkrahur dhe bashkëpunuar me të gjitha forcat nacionaliste sidomos me çetën e Azem Galicës. Përkrahu dhe ndihmoi lëvizjen çlirimtare që zhvillohej në Kosovë, duke krijuar një zonë të lirë në Malësinë e Gjakovës (Tropojë). Bashkëpunoi dhe mbante kontakte me udhëheqësit e lëvizjeve kombëtare të popujve të Ballkanit që luftonin për t’u çliruar nga robëria serbe. Në qeverinë e Sylejman Delvinës, e cila doli nga Kongresi i Lushnjës më 1920, u zgjodh anëtar i Këshillit Kombëtar dhe ministër pa portofol. Më 1921 në qeverinë e Hasan Prishtinës u caktua komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura të Shqipërisë. Me ardhjen në pushtet të Ahmet Zogut kaloi në krahinën e Krasniqes, ku vazhdoi qëndresën kundër pushtetit të tij. Ishte ndër udhëheqësit kryesor të forcave demokratike në Shqipëri, që sulmuan repartet qeveritare dhe sollën fitoren e Revolucionit të Qershorit më 1924. Në vjeshtën e vitit 1924 udhëtoi në Gjenevë, për të paraqitur para Lidhjes së Kombeve çështjen e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera nën regjimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene. Qëndresën kundër regjimit të Zogut e vazhdoi deri në vitin 1925, kur u rrethua dhe u vra nga forcat qeveritare në Shpellën e Dragobisë. (Jusuf Bajraktari).

CURRI Debatik (1984-). Futbollist. Lindi në Prishtinë dhe hapat e parë në futboll i nisi te skuadra e “Prishtinës”; debutoi në ekipin e parë në vitin 2003. Pas dy vjetësh kaloi te skuadra “Vorskla Poltava” e Ukrainës. Gjatë pesë vjetëve

me këtë ekip kishte 148 paraqitje dhe shënoi 19 gola, duke arritur që ekipi i tij të fitonte Kupën e Ukrainës (2009). Nga “Vorskla” u largua si futbollist i lirë dhe vazhdoi karrierën në Superligën e Turqisë, te ekipi “Genclerbirligi” (2010-2013). U kthye sërish në Ukrainë te skuadra “Hoverla Uzhorod” dhe më vonë iu bashkua skuadrës së “Sevastopolit” (2014), prej nga u largua pas ndarjes së Krimesë nga Ukraina. Në verën e vitit 2014 iu bashkua “Tiranës”, skuadrës më të suksesshme në Shqipëri, ndërsa dy vjet më vonë u kthye në KF “Prishtina”. Nga viti 2006 është ftuar rregullisht edhe nga kombëtarja e Shqipërisë. (Arsim Maxhera)

CURRI Hysni (?-1925). Luftëtar i lëvizjes për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Lindi në Gjakovë. Ishte nipi i tretë i Bajram Currit, udhëheqës ushtarak i kryengritjeve të viteve 1910-1912. Komandoi forcat shqiptare në Qafën e Prushit kundër ushtrisë osmane më 7 gusht 1912. Ishte pjesëmarrës i delegacionit shqiptar në vizitë Austrisë më 16 prill 1917. Major H. Curri ishte anëtar aktiv dhe nënkryetar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”. Pas Kongresit të Lushnjës (1920), së bashku me Bajram Currin, ndihmoi Ahmet Zogun për konsolidimin e shtetit shqiptar. Më 27 gusht 1923 udhëtoi me një grup veprimtarësh nga Shëngjini për në Itali dhe prej andej në Austri, ku mori premtime dhe përkrahje për armatim nga Austria. Vdiq në Vjenë më 1925. U varros në varrezat qendrore të Vjenës “Zentralfriedhof” me nderime të larta, ku merrnin pjesë personalitete të njohura austriake, përfaqësues të disa organizatave nga vendet ballkanike dhe të emigracionit shqiptar. (Lush Culaj)

CURRI Vjollca (1964-). Balerinë. Lindi në Beograd. Shkollën e mesme të baletit e kreu në Beograd. Në ansamblin e baletit të Teatrit Popullor Krahinor të Kosovës interpretoi në këto shfaqje: “Interplay”, “Kënga e Rexhës”, “Don Kishoti”, “E bukura More” dhe “Pjetër Pani”. Jeton në Francë. (Selman Jusufi)

CVIJIQ (Cvijić) Jovan (1865-1927). Gjeograf dhe etnolog serb, mbështetës i fuqishëm i idesë së hegjemonizmit serb në Ballkan. Lindi në Lloznicë (Serbi), studioi në Beograd dhe Vjenë. Ishte profesor dhe rektor i Universitetit të Beogradit dhe kryetar i Akademisë Mbretërore

Serbe të Shkencave. Ishte themelues i shkollës gjeografike të drejtimit antropogjeografik dhe i edicionit “Vendbanimet dhe prejardhja e popullsisë”, me të cilin, përmes botimeve të shumta dhe me interpretim racist të fenomeneve gjeopolitike, historike dhe etnodemografike influencoi në ngjarjet politike në Ballkan, veçanërisht pas vitit 1912. Me veprat e tij të shumta vuri bazat gjeografike dhe gjeopolitike të synimeve ekspansioniste serbe ndaj vendeve fqinje dhe popujve joserbë, në veçanti josllavë. Duke imituar Garashaninin, u bë ndër ithtarët kryesorë i synimit të Serbisë për daljen e saj në Detin Adriatik, përmes okupimit të Bosnjës dhe Shqipërisë. Në shkrimet e tij spekulonte me argumentet etnodemografike dhe gjeopolitike në favor të serbëve dhe në dëm të popujve të tjerë. Malazezët i konsideronte fis serb; bullgarët i konsideronte si komunitet të paqartë në pikëpamje etnike, linguistike e psikologjike, por të afërt me serbët; ndërsa maqedonasit i quante

“masë flotante”, pa vetëdije kombëtare, strukturë kombëtare serbo-bullgare dhe Maqedoninë e quante “Serbi e Vardarit”. Shqiptarëve u mohonte qenien politike-kombëtare, i cilësonte pa traditë historike dhe pa vetëdije kombëtare, të prirë për dhunë dhe sjellje jokulturore. Tezë kryesore e J. Cvijiqit ishte se Kosova, “shpirti mesjetar serb”, ishte populluar me shqiptarë nga Shqipëria Veriore, pas “dyndjes masive” të serbëve pas luftërave austro-turke të viteve 1689-1690 dhe 1737-1739, duke i “islamizuar dhe shqiptarizuar” në përmasa të mëdha serbët e mbetur. Në Konferencën e Paqes në Versajë (1918-1920) ishte shef i delegacionit serb dhe drejtonte seksionin etnografik-historik të saj, ku bëheshin edhe hartat etnike dhe caktoheshin kufijtë. Në fillim të shekullit ishte i angazhuar edhe në skenën publike të Serbisë, frekuentonte klubin “Slovenski jug”, anëtarët e të cilit vepronin ilegalisht në organizatën terroriste “Crna ruka”. (Hivzi Islami)

ÇABEJ Eqrem (1908-1980). Gjuhëtar, albanist, ballkanolog, akademik. Një ndër gjuhëtarët shqiptarë më me ndikim. Gjirokastrit i lindur në Eskishehër të Turqisë, shkollimin fillor e



EQREM ÇABEJ

ka marrë në Gjirokastrë. Gjimmazin e ka përfunduar në Klagenfurt (1923-1926), dy semestra të studimeve në Grac (1927) dhe pjesën tjetër në Vjenë (1930-1933). Studioi filologji, gjuhësi, histori të Ballkanit, dije për kulturat dhe popujt e këtyre hapësirave, gjuhësi krahasimtare indoeuropiane, filologji klasike. Doktoroi në Vjenë më 1933, me temën “Studime italo-shqiptare” (Italoalbanische Studien). Pas studimeve është kthyer në Shqipëri për të punuar si mësimdhënës në shkollat e mesme në Shkodër, Elbasan, Tiranë dhe Gjirokastrë. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte i shënjuar në aspektin klasor. Refuzoi të bëhej pjesë e Institutit të Studimeve Shqiptare më 1942 dhe refuzoi postin e ministrit të Arsimit në Qeverinë e Rexhep Mitrovicës. Pas lufte u caktua të punonte në Institutin e Studimeve të sapothemeluar (pararendës i Universitetit të Tiranës). Më vonë ishte profesor në Universitetin e Tiranës, ku mbajti lëndët histori e gjuhës shqipe dhe fonetikë historike. Ishte anëtar i komisionit hartues të “Fjalorit të gjuhës shqipe” të vitit 1954. Ndihmesa e Çabejt në studimet shqiptare është sa një shkollë e tërë, duke rritur nivelin e albanologjisë në periudhën e viteve ’50-’80. Kontribuoi që nga vitet tridhjetë në shumë fusha: studime etimologjike, tekste të vjetra të shqipes, histori e gjuhës shqipe, kontaktet e shqipes, dialektologji, standardizim i gjuhës. Botoi shumë artikuj për gjuhësinë, por edhe për folklorin dhe

letërsinë. Në albanistikën shqiptare solli nivelin e traditës së albanistikës deri atëherë më të lartë europiane, duke bërë një sintezë të këtyre dijeve, të metodave dhe të rezultateve. Në vitet 1971-1973 mbajti leksione në Universitetin e Prishtinës për studentët e magjistraturës. Nga ato leksione është botuar vëllimi “Gjuhësi krahasimtare”. Nga studimet e tij veçohen botimi kritik në dy vëllime për “Mesharin” e Buzukut (Tiranë, 1968) dhe studimet për etimologjimë e shqipes. Para Luftës së Dytë Botërore botoi “Elemente të gjuhësisë dhe të letërsisë shqipe, me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme” (1936) dhe “Shqiptarët ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit” (1939). Pas luftës është përqendruar në gjuhësinë historike, duke botuar filimisht “Hyrje në fonetikën e gjuhës shqipe” e pastaj “Fonetikën historike të gjuhës shqipe”. Trajtoi në mënyrë të veçantë shumësin e singularizuar të shqipes. Vepra e tij e përmbledhur “Studime gjuhësore” është botuar në nëntë vëllime nga “Rilindja” në Prishtinë, duke filluar nga vitit 1976. Tani ka përfunduar botimi i “Fjalorit etimologjik” në 7 vëllime në Tiranë. Shquhet si mbrojtësi më i rëndësishëm i tezës për prejardhjen ilire të shqipes. Më 2008 është botuar përmbledhja e tij me sonete. Është dekoruar dy herë me Çmimin e Republikës dhe Urdhrin “Nderi i Kombit”. (Bardh Rugova)

ÇABRATI. Kodër (pllajë) mbetëse e tarracës më të ulët të fazës liqenore në lartësi 440-460 m, 65-70 m diferencë në lartësi nga pika trigonometrike në qendër të qytetit të Gjakovës. Nga rrjedha e ujit liqenor nëpër lumenj, ky liqen gradualisht është shndërruar në toka. Prej asaj kohe e deri më sot në Çabrat dominojnë proceset erozive, të cilat kanë modeluar relievin e kësaj pllaje. Çabrati është krijuar në formacione të reja të erës kenozoike (policen-kuaternar), ku kryesisht



PEIZAZH NGA ÇABRATI

dominojnë tokat liqenore në formë ranishte dhe të melës-deltinës. Kodra e Çabratit zë vend në perëndim të qytetit të Gjakovës, në të djathtë të lumit Krena, prej Shpatit të Sylpejës në veri, deri në rrjedhë të Erenikut dhe Ura e Tabakëve në jug, me gjatësi mbi 4 km. Në perëndim të Çabratit vazhdojnë malet e Junikut dhe të Shkëlzenit. Midis tyre gjendet lugina e lumit Erenik. Në llojshmërinë e relievit, Çabrati përbëhet prej disa lugjeve: Lugu i Dragoit, Lugu i Mejës, Lugu i Dashit, Lugu i Balës. Toka argjilore-meladeltina tradicionalisht përdoret për prodhimin e tullave dhe tjegullave; është përdorur edhe nga vorbëtarët. Në shpatet e Çabratit deri në vitet '60 të shek. XX është kultivuar hardhia e rrushit, kajsia, pjeshka, qershia. Në mungesë uji, verës në tokat e smonicës liqenore krijohen çarje të ashpra dhe të thella. Në pllajën e Çabratit dallohen këto lëndina (tabe): Lëndina e Madhe, Lëndina e Vogël, Lëndinat e Voshës. (Nesim Vala)

ÇAJUPI Andon Zako (1866-1930). Poet, dramaturg, veprimtar politik i Rilindjes Kombëtare. Lindi në Sheper të Zagorisë. Pas shkollës greke të vendlindjes, shkollimin e mesëm e vijoi më 1882 në Kolegjin francez “Sainte Catherine” në Aleksandri.



ANDON ZAKO
ÇAJUPI

Kreu studimet për drejtësi në Gjenevë (1887-1892). Mbas martesës jetëshkurtër me ziceranen Evgjieni, që ndërroi jetë gjatë lindjes së Stefanit, birit të tyre, u kthye në Egjipt. Braktisi shpejt avokaturën dhe më 1896 u përfshi në lëvizjen e shqiptarëve të Egjiptit, si organizator e drejtues aktiv i shoqërisë

“Vëllazëri e shqiptarëve” e më pas i “Shoqërisë së miqve”. Vdiq në Kajro. Nga viti 1958 prehet në Memorialin e Rilindësve në Gjirokastër. Një pjesë e veprave iu botua pas vdekjes, siç ndodh edhe me dy prozat e para, shkruar frëngjisht “Historia e një familjeje” dhe “Mysafirët e Çajupit”, ndërsa botoi të “Shqipëria” e Bukureshtit artikullin e parë “Në kërkim të një alfabeti”, pro alfabetit latin të shqipes. Nga frëngjishtja vijnë dhe dy shqipërimet: “Përralla të sgjedhura nga të vjershëtorit math La Fontaine” (Kairo, 1921) dhe “Lule të Hindit” (Kairo, 1922). Përmbledhja “Këngë dhe vome”, drama “Detyra”, konsiderohen të humbura. Nën pseudonimin letrar “Çajupi”, vepra e tij gërsheton frymën romantike të Rilindjes me frymën kritike që nxit vetë kriza e saj. Lirik i një poezie atdhetare vokative, i mallëngjimit patriotik, por edhe i veprimit, me vargun dhe figurën e kthjellët të poezisë popullore labe i qaset botës reale shqiptare edhe përmes ligjërimit sarkastik. Plani i parë e afron me Naimin, i dyti me Konicën e Fishtën. Çajupi mbetet specifik në lirikën erotike, me nota të thella lirizmi sensual e hedonist të shijes për jetën, femrën dhe erosin. Prirja për kontrastin shfaqet që te përmbledhja “Baba-Tomorri” (Kairo, 1902). Poezia “Mëmëdheu”, e thjeshtë në poetikë, përkufizon thellë identitetaren e antropologjikën e atdheut, ndërsa “Vaje” mbetet një nga pak elegjitë delikate të shqipes, krahas asaj të De Radës e Serembes. Satirikja triumfon te komedia “Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr”, ku, njohës i mirë i psikës dhe ligjërimit popullor, ndërton një nga polifonitë e para dramatike, me skena karnavaleske nga më origjinalet. Satirën dramatike e vijoi me komedinë “Pas vdekjes”, vepër postume, shkruar më 1910 dhe ripunuar më pas, me skena tashmë qytetëse, ku përqeshet në situata groteske kotësia njerëzore, pseudopatriotizmi politik e kulturor i xhonturqve shqiptarë, të tallur edhe te pamfleti “Klub’ i Selanikut”, botuar te “Rrufeja” e Jani Vruhos (1909). Gjininë dramatike Çajupi e sprovoi edhe me tragjedinë “Burr’i dheut” (1907), vepër postume, kushtuar Skënderbeut, shkruar në frymën e Rilindjes në emër të bashkimit kombëtar dhe lëvrimit letrar të shqipes, e ndërtuar mbi parime aristotelike e jodokumentare dhe sipas modelit rasinian. Vepër postume është edhe satira e gjatë “Baba Musa Lakuriq” (punuar 1902-1922) me mbi 6,000 vargje, cilësuar “përrallë” nga autori. Në thelb qëndron loja me mitet biblike të

“Dhjatës së Vjetër”, ku mbizotëron marrëdhënia komplekse e burrit me gruan, me joshjen, dashurinë, lakminë, tradhtinë, intimen etj., si të vërteta universale, të lakuriqta e arketipore, që sprovohehen si parabola biblike në përditshmërinë e jetës reale e plot humor, kryesisht të bashkëkombësve të poetit. (Persida Asllani)

ÇAKA Fadil (1961-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Bob të Kaçanikut. Studioi për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Iu bashkua radhëve të UÇK-së në qershor të vitit 1998. Kaloi disa herë kufirin e Shqipërisë për armë dhe municione. Nga komanda e Brigadës 162 “Agim Bajrami” ishte i ngarkuar edhe me detyra të tjera. Ishte pjesëmarrës në betejat që u zhvilluan në Gajre (shkurt 1999), në Ivajë dhe Kotlinë (mars 1999) dhe në Rakoc të Kaçanikut (prill 1999). Në betejën e Rakocit ra heroikisht në frontin e luftës së bashku me disa bashkëluftëtarë të tjerë të batalionit të dytë të Brigadës 162 “Agim Bajrami”. (Haxhi Ademi)

ÇAKOLLI Zyhdi (1939-2009). Grafist. Lindi në Pejë. Kreu Akademinë e Arteve Figurative në Prishtinë. Specializoi për dizajnin grafik në Institutin e Arteve “Surikov” në Moskë. Disa vjet punoi në Athinë, duke u marrë me reklama filmi. Nga viti 1981 jetoi në Raqibuzh të Polonisë. Ishte anëtar i Unionit të Artistëve të Polonisë dhe i Unionit të Artistëve “Yawa”. Më 1991 hapi shkollën private të specializimit për artet pamore. Ishte bashkorganizator i Bienales ndërkombëtare të vizatimit dhe grafikës “Exlibris” në Raqibuzh në vitet 1996-2002. Hapi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive në Poloni dhe në vende të tjera. Punimet e tij gjenden në koleksione dhe institucione shtetërore e private në shumë vende. Vdiq në Poloni. (Basri Mekolli)

ÇAMËRISHTJA. Idiomë dialektore që përfshin të folmet e disa viseve të toskërishtes jugore. Shtrihet në zonat e Konispolit, të Murësit e disa të tjerave brenda pjesës më jugore të Shqipërisë dhe në rrethet e Filatit, të Gumenicës, të Margëlliqit, të Paramithisë e deri te Preveza, brenda Greqisë. Në veri shkon deri te lumi Pavëll, kurse në jug deri në Gjirin e Prevezës. Emri i sotëm Çamëri shpjegohet nga Çabej si vijim i drejtpërdrejtë mbi bazë

të ligjeve fonetike të shqipes nga emri i vjetër *Thyamis*, i cili shënonte lumin. Çamërishtja karakterizohet nga disa tipare të moçme, siç janë ruajtja e grupeve konsonantike *kl*, *gl* dhe ruajtja e *l*-së së vjetër ndërzanore: *klumësht* (*qumësht*), *klaj* (*qaj*), *klafë* (*qafë*), *i shklier* (*i shqyer*), *klishtë* (*qishë – kishë*) *gluri* (*gjuri*), *glisht* (*gisht*), *glëmb* (*gjëmb*) *bilë* (*bijë*), *fëmilë* (*fëmi-jë*), *golë* (*gojë*) etj. Si veçori të tjera specifike të çamërishtes duan përmendur mungesa e *y*-së: *grika* (*gryka*), *hiri* (*hyri*), kalimi i *ë*-së në disa raste në *i*: *ishtë* (*është*), *bij* (*bënj*), *gjij* (*gjënj*) etj. Zanoret e gjata në këtë të folme janë tipar relevant. Togjet konsonantike: *mb*, *nd*, *ng janë asimiluar*: *pesmjet*, *mrapa*, (*pesëmbëdhjetë*), *nonjë* (*ndonjë*), *brëna* (*brëna*) të *gritur* (të *ngritur*), *grënë* (*ngrënë*), *gasin* (*ngasin*) etj. Akuzativi i vjetër në çamërishten është konservuar dhe si i tillë gjallon: *surrinë*, *fshanë*, *djalnë* etj. Në paradigmen e aoristit janë të përhapura trajtat e v. III të shumësit me asimilimin e grupeve: *dhn-*, *-ln-*, *-lln-*, *-tn-*. (Imri Badallaj)

ÇAMI-KYÇYKU Muhamet (1772-1844). Njëri ndër krijuesit më produktivë në mesin e shkrimtarëve të alhamiados shqiptare. Lindi në Konispol të Çamërisë, i shkolluar fillimisht në vendlindje, ku mbaroi mejtepin dhe medresenë. Më pas studioi në universitetin “Al-Az’har” në Kajro, ku mësoi gjuhët orientale dhe mori një formim të plotë në fushat e filozofisë, teologjisë, letërsisë, etikës e sociologjisë, të cilat i shfrytëzoi me mjeshtri në veprat që shkroi shqip. Me t’u kthyer nga Kairoja, filloi të punonte si imam dhe profesor në Medresenë e Konsipolit dhe u bind se shqipja si gjuhë e gjallë duhej shkruar për t’i kontribuar emancipimit të popullit. Si poet, M. Çami i dha letërsisë shqipe novelën e parë të quajtur “Erveheja”, të vargëzuar në tetërrokëshin e poezisë popullore, e cila ishte nga veprat më të lexuara gjatë Rilindjes Kombëtare. Ai shkroi edhe novelën tjetër “Jusufi dhe Zelihaja”, e mbështetur në tregimin kuranor të Sureja Jusuf. Duke i dhënë asaj formën letrare dhe duke e zgjeruar dhe realizuar mjeshtërisht, e ruajti mesazhin e etikës islame. Ka lënë dhe vepra me tematikë shoqërore si “Bekriu”, “Gurbetlinjtë” dhe me temë historike “Zaptimi i Misolongjit”, si dhe një sërë veprash me tematikë fetare-autoriale, përfshirë edhe përkthime. Ishte pedagog e imam i shquar, talent i rrallë e produktiv, që

shkroi shumë vepra artistike-letrare, me të cilat ngriti artin e shkrimit dhe vetëdijen gjuhësore. (Abdullah Hamiti)

ÇANGA Tefik (1911-1944). Mësues, veprimtar antifashist. Lindi në Shkodër. Shkollën fillore e kreu në Perash dhe në fshatin Kastriot të Peshkopisë, ku më pas punoi si mësues. Më 1933 regjistrohet në gjimnaz të shtetit. Ishte student i Fakultetit të Arteve në Bukuresht (1938). Mori pjesë në demonstratat kundër pushtimit fashist të Shqipërisë në Bukuresht (7 prill 1939). Në verën e vitit 1939 kthehet në Shqipëri, por autoritetet e pushtetit fashiste nuk e lënë të kthehet në Bukuresht, për të vazhduar studimet. Më 1942 vjen në Kosovë, ku vendoset në Ferizaj. Ishte i përfshirë në organizatën e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në Ferizaj ishte drejtor i magazinës së drithit “Sasteb”. Mori pjesë në Konferencën e Bujanit si delegat i Ferizajt. U arrestua në maj të vitit 1944, në Prapashticë, ndërsa në gusht të vitit 1944 fashistët e ekzekutojnë me varje në Pazarin e Vogël në Gjakovë. (Skënder Lutfiu).

ÇAPARI Gjakush (1933-1976). Folës i Radio Prishtinës dhe përkthyes. Lindi në Tiranë. Familja e tij u vendos në Prizren në vitin 1946. Filloi punë si spiker në vitin 1958 në Radio Prishtinë. Ishte njëri ndër folësit më të hershëm dhe më dalluar të Radio Prishtinës, me diksion të pastër dhe zë karakteristik. Ishte lexues i rregullt i lajmeve në këtë radio për vite të tëra, njohës i mirë i mediumit dhe mësues i një gjenerate të spikerëve të Radio Prishtinës. Për punën e tij profesionale u nderua me çmime dhe mirënjohje. Ishte edhe përkthyes i veprave letrare (Hector Malo, “Pa familje”) dhe i teksteve të ndryshme shkollore. (Nehat Islami)

ÇAPRIQI Basri (1960-2018). Poet, studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Krythë të komunës së Ulqinit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Ulqin, ndërsa studimet e letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1983). Në fillim punoi si gazetar në Radiotelevizionin e Malit të Zi në Podgoricë, kurse në vitin 1986 u zgjodh asistent i lëndës letërsi e sotme shqipe



BASRI ÇAPRIQI

në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Po në këtë fakultet kreu studimet pasuniversitare dhe më pas mbrojti tezën e disertacionin të doktoratës (2004). Ndërkohë, në Universitetin e Edinburgut mori diplomë me temën “Poezia konkretiste e Edvin Morganit”. Në degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe u angazhua të mbajë ligjërata nga lëndët stilistikë dhe semiologji, duke u avancuar në titujt përkatës universitarë. Në vitin 2004 u zgjodh kryetar i parë i PEN Qendrës së Kosovës, funksion që e ushtroi për shumë vjet me radhë. Për dy mandate ishte kryetar i këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës. Si kryetar i Pen Qendrës së Kosovës, mori pjesë në kongrese, konferenca dhe në shumë takime ndërkombëtare të shkrimtarëve. Ka botuar vëllimet poetike: “Ulli me dy mijë unaza” (1983), “Në fund të verës” (1986), “Ma qet gjuhën” (1989), “Frutat bizare (1996)”, “Burimi nën gjuhë” (2005), “Zbutja e gjarprit” (2006), “Përkryerja e shiut” (2013). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji të poezisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Libra me poezi të tij të zgjedhura janë botuar në anglisht “Grass on the Window” (1996), në rumanisht “Deschiderea scoicii” (2010) dhe në gjuhën malazeze “Savršenstvo kiše” (2012). Ka publikuar vështrime kritikë, studime dhe monografi: “Mikrostruktura e tekstit” (1990), “Aksidenti i orës shqiptare” (1993), “Përmasat e kontekstit” (1998), “Simboli dhe rivalët e tij” (2005), “Paradigma Kadareane” (2006). Përveç shkrimeve publicistike, ka botuar edhe një sërë shkrimesh prezantuese dhe kritike për autorë të rëndësishëm të letërsisë shqipe, si Martin Camaj, Azem Shkreli, Ismail Kadare, Ali Podrimja, Rahman Dedaj etj. Është bashkautor i botimit “Antologji e poezisë shqipe të shekullit XX”, hartuar nga PEN Qendra e Kosovës dhe e Shqipërisë. (Isak Shema)

ÇAPRIQI Sazana (1964-). Studiuese, përkthyes dhe mësimdhënëse e letërsisë angleze në Universitetin e Prishtinës. Lindi në Prishtinë. Po aty kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës, ku kreu dhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2009). Karrierën e mësimdhënës e nisi më 1986 në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa nga viti 1990 punon në Universitetin e Prishtinës. Më 1997 themeloi Shoqatën për hulumtime dhe

botime të grave “Sfinga Center” dhe po atë vit nisi botimin e revistës kulturore për studimet gjinore “Sfinga”. Përveç publikimeve në gazeta e revista të huaja, në gjuhën shqipe botoi dy libra studimorë: “Letërsia e grave - perspektiva krahasuese” (2006) dhe “Shkrimi femëror” (2011). Sistematikisht u mor me përkthime nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas, si: “Bari mbi dritare” (The Grass on the Window), poezi të B.Çapriqit (1992), “Zërat e shiut” (Sheamus Heaney, 1995), “Një dhomë për vete” ese nga Virginia Woolf (1997), “Si të lexohet - ese angloamerikane” (1997) dhe përktheu në gjuhën angleze disa autorë shqiptarë. (Agron Gashi)

ÇAPUNI-BRESTOVCI Meshqyre (1946-2013). Mjeke, oftalmologe, profesore universiteti. Lindi në Ulqin. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, kurse shkollën e mesme të mjekësisë në Cetinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë në vitin 1970. Mbaroi specializimin në lëmin e oftalmologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ndërsa në vitin 1986 mbrojti edhe tezën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Është bashkautore e tekstit universitar “Okulistika”. Mori pjesë në kongrese, konferenca dhe simpoziume shkencore, si dhe botoi disa punime shkencore si autore dhe bashkautore. Mbante titullin profesor ordinar i lëndës së oftalmologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku punoi derisa u pensionua më 2011. (Ilhami Goranci)

ÇARKAXHIU Kemal (1943-2012). Gazetar i sportit. Lindi në Ferizaj. Njihet si një nga pionierët e gazetarisë sportive televizive në Kosovë. Ishte pjesë e redaksisë së TV Prishtinës në gjuhën shqipe, që transmetonte program nga Beogradi. Më pas mori pjesë në konsolidimin e redaksisë së sportit në TVP. Ndër të parët filloi me komentimin e transmetimit të ndeshjeve televizive, në veçanti ato të hendbollit. Pos transmetimeve në Kosovë, në qytete e vende të ndryshme në ish-Jugosllavi, ai komentoi edhe kampionate europiane e botërore, përfshirë edhe lojëra olimprike dhe ngjarje të tjera të rëndësishme sportive. Mori pjesë në transmetimin e parë të drejtpërdrejtë të TVP-së në vitin 1974, nga Kampionati Botëror i Futbollit në Gjermani. (Ejup Llumnica)

ÇARMATIMI I SHQIPTARËVE (1918-1941). Proces i çarmatimit të shqiptarëve nga pushteti serb, që nis me pushtimin e Kosovës më 1913, për të vazhduar në formë më të institucionalizuar pas Luftës së Parë Botërore. Ky proces u mbështet në të ashtuquajturin “Ligjin mbi hajdutët” të vitit 1905. Zbatimi i këtij ligji fillon në nëtor të vitit 1918 në qarkun e Pejës dhe u shtri deri në Plavë dhe Guci. Pushteti nga 20 shkurti 1919, për gjashtë muaj ndërmori aksione të dhunshme përmasash të mëdha në Drenicë, Shalë të Bajgorës, Vushtrri, Llap dhe Gallap. Në muajt mars-prill të vitit 1919 çarmatimi përfshin Prishtinën, Prizrenin dhe Gjilanin, ndërsa më vonë edhe trevat e Ferizajt, Kaçanikut dhe Shkupit, duke u ndarë në dy drejtime: kah Tetova për Gostivar deri në Dibër dhe kah Kumanova deri në Preshevë dhe Vrajë. Gjatë kësaj kohe do të çarmatosen 1,811 fshatra, do të pushkatohen 1,812, ndërsa u plagosën 12,128 shqiptarë. Para se të niste aksioni i çarmatosjes, thirrreshin në biseda krerët dhe personalitetet e njohura të krahinave të caktuara, si Azem Bejta, Ramë Vllasa të cilët kërcënoheshin me vrasje dhe me internim të familjeve. Fushata e çarmatosjes përsëritet herë pas here deri në mars 1923, pastaj gjatë viteve 1938-1940 në tërë Kosovën. Se çarmatosja ishte vetëm pretekst për dhunë sistematike mbi popullsinë e pambrojtur, dëshmon fakti se nga ky aksion në tërë Kosovën u mblodhën vetëm 21 pushkë dhe 36 fishekë. Në të vërtetë, qëllimi i aksionit ishte presioni për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Si gjatë viteve 1918-1923, kur u zhvillua aksioni i parë i armëve, ashtu edhe më pas, në vitet 1938-1940, 95% të armëve ishin të shpërndara nga pushteti, për të krijuar pretekstin e akuzave, të dhunës dhe vrasjeve sistematike ndaj shqiptarëve. (Hakif Bajrami)

ÇARSHITË E VJETRA (shek. XV-1912). Janë komplekse arkitektonike me ndërtime private-publike, që shfaqen në disa qytete të Kosovës, si në Prishtinë, Pejë, Vushtrri, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Kaçanik e Gjilan. Çarshitë paraqiten si fenomene unike të aglomeracionit historik dhe urban në Kosovë, si dhe në vende të tjera të rajonit. U ndërtuan gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane në Kosovë. Tregu lokal apo pazari dhe xhamitë paraqesin bërthamën e çarshive të vjetra. Tregu lokal ishte një karakteristikë paraosmane të shqiptarët. Karakteristikë për



PAMJE E ÇARSHISË SË GJAKOVËS

këto komplekse ishte ndërtimi i dyqaneve përreth xhamive, që ndodh me çdo kompleks të çarshive të vjetra në Kosovë. Fillim i formimit të këtyre aglomeracioneve historike urbane merret kryesisht gjysma e dytë e shek. XV. Nga kjo periudhë, varësisht nga qyteti, përreth objekteve të kultit muhamedan filluan të ndërtoheshin dyqanet me zeje dhe dedikime të ndryshme. Çarshitë e vjetra të qyteteve të Kosovës, si pjesë e tërësive unike urbane, u krijuan si nevojë e urbanizimit të qytetit, me qëllim të zhvillimit të zejtarisë e të tregtisë, sipas parimit esnaf, të lokalizuar në rrugica e rrugë të caktuara. Ndarja dhe organizimi i këtyre karakteristik, me rrugicat dhe rrugët e lakuara, kishin karakterin e çarshisë, të prodhimit dhe të tregtisë së pavarur. Kjo mënyrë e ndarjes së çarshive të vjetra, në atë të tregtisë dhe të zejtarisë, sipas veprimtarisë së caktuar, është karakteristikë për sistemin osman, që u bart edhe në këto vise, ku mjeshtërit vendorë dhanë kontributin e tyre në realizimin arkitektural të ndërtimeve, duke i pasuruar ato me frymë specifike vendore. Këto ndërtime u ruajtën për shumë kohë në Kosovë, në viset shqiptare dhe në tërë Ballkanin deri në vitin 1912. Për nga planimetria, materiali ndërtimor dhe teknika e ndërtimit, në komplekset e çarshive paraqiten disa tipa të dyqaneve. Dyqanet ishin në kat dhe përdhes dhe nga jashtë siguroheshin me qepena. Çarshitë e vjetra ishin një lloj i muzeve nën qiellin e hapur, të veshura me mozaikë varietetesh të ndryshme,

me arkitekturë specifike enterierësh, të punuar nga mjeshtërit shqiptarë me përvojë. Çarshitë e vjetra të disa qyteteve të Kosovës, edhe pse në tërësi nuk janë të ruajtura, ato paraqesin një fenomen unik të aglomeracionit historik urban në territorin e Kosovës dhe më gjerë. Në këto bërthama historike të qyteteve, stilistikisht deri diku homogjene dhe autentike, aty-këtu ende vazhdon ritmi i jetës esnafa, me tradita specifike të marrëdhënieve zejtare-tregtare. (Fejaz Drançolli)

ÇAUSHI Bardhyl (1936-1999). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e kreu në Prishtinë. Më pas regjistroi Fakultetin Juridik




BARDHYL ÇAUSHI

në Universitetin e Beogradit, për ta vazhduar në Universitetin e Shkupit, ku diplomoi në vitin 1959. Ishte gjykatës i gjykatës komunale dhe gjykatës i Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe kryetar i Gjykatës komunale në Gjakovë. Magjistroi në vitin 1972 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, kurse doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit (1989). Në vitin 1970 u zgjodh asistent, pastaj ligjërues dhe profesor inordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës për lëndën e drejta romake. Ushtrroi detyrën e dekanit të Fakultetit Juridik dhe ishte kryetar i parë i Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës. Botoi punime shkencore si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Studimet e B. Çausit trajtojnë aspektet krahasuese të së drejtës zakonore shqiptare me të drejtën romake sa i përket fushës civile-juridike, ndër të cilët veçohen: “Besa-një ndër mbështetjet e vazhdimësisë iliro-shqiptare” (1974), “Besa-Bona fides, ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre” (1978), “Kontrata e huas sipas të drejtës romake” (1980) etj. Gjatë luftës së Kosovës së vitit 1999 u vra nga forcat pushtuese serbe. (Osman Ismaili)

ÇAUSHOLLAJT. Një nga familjet kryesore të parisë lokale të Shkodrës, nga e cila kanë dalë funksionarë të niveleve të ndryshme të administratës osmane. Ashtu si Begollajt, Toptanët, Alltunët, Biçakët, Vërlacët etj., koha e daljes së kësaj familjeje në skenë lidhet me

procesin e integritit të popullsisë vendëse në strukturat shtetërore osmane dhe me procesin e humbjes së autoritetit të Stambollit në rajonet periferike të perandorisë. Në gjysmën e parë të shek. XVIII familja e Çaushollajve rivalizonte me Begollajt e Pejës për kreun e sanxhakut të Shkodrës. Në shkurt të vitit 1739, një nga pinjollët kryesorë të familjes Çaushollaj, Jusuf Pasha, duke pasur përkrahjen e disa rretheve zejtare dhe tregtare të qytetit dhe të një pjese të malësorëve të rrethit, rrëzoi nga pushteti rivalin e tij nga familja e Begollajve dhe siguroi postin e mytesarifit të sanxhakut të Shkodrës. Kjo familje e kontrolloi pushtetin në Shkodër, ndonëse me ndërprerje, deri në vitin 1756, kohë që shënon edhe kulmin e fuqisë së saj. Në 1756 Mehmet Pashë Çausholli bëri përpjekjen e fundit për të dalë në krye të sanxhakut. Më pas, gjatë periudhës së qeverisjes së Shkodrës nga Bushatllinjët për gati 75 vjet, Çaushollajt vazhduan të luanin një rol të rëndësishëm në raportet dhe ekuilibrat mes pushtetit osman dhe Bushatllinjve. Edhe kjo familje shqiptare e humbi peshën e vet pas vitit 1831, kur ra Pashallëku i Shkodrës dhe bashkë me të ra edhe pesha tradicionale e familjeve shqiptare në administratën provinciale osmane. (Dritan Egro)

ÇAVDARBASHA Agim (1944-1999). Skulptor, akademik. Lindi në Pejë. Përfundoi Shkollën e Mesme të Arteve në vendlindje, ndërsa Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1969) te prof. V. Vujisiq. Kreu studimet pasuniversitare në Lubjanë (1971). Ishte anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1970. Është autor i dy shtatoreve të tribunëve të Lidhjes Shqiptare të



AGIM
ÇAVDARBASHA

Prizrenit, Abdyl Frashërit dhe Ymer Prizrenit në Prizren, si dhe të Sylejman Vokshit e Bajram Currit në Gjakovë. A. Çavdarbasha u sprovua me forma, me zogj e pëllumba, pastaj me sfera e hemisfera dhe me sprovua instalative, por kurë nuk e braktisi figurën, në veçanti figurën e femrës. Femra e tij nuk e ka bukurinë përrallore, por ajo ka shkëlqimin e brendshëm, falë të cilit gjallëron, shndrit edhe nga jashtë, sado që duket si masë inerte, me gjymtyrë të rudimentuara e me klithje të frenuara. Pikërisht pse

duket e tillë, ajo është aq sugjestive dhe tokësore, e mbi të gjitha tepër njerëzore. Një kohë ligjëroi në Shkollën e Lartë Pedagogjike, ndërsa më 1974 u zgjodh pedagog në Akademinë e Arteve në Prishtinë, në degën e skulpturës, ku punoi deri në fund të jetës. Organizoi një sërë ekspozitash individuale: në Galerinë e Shtëpisë së Rinisë, Beograd (1969), “Ekspozita e portreteve”, Foajeu i Teatrit Popullor në Prishtinë (1975), në “Mala Galerija”, Lubjanë (1979), në Galerinë e Arteve në Prishtinë (1981), në Galerinë “Forum” (me Muslim Mulliqin) në Zagreb (1982), në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës në Tiranë (1993), në Shtëpinë e Hajnrih Bëllit, në Langerbojh dhe në Eifel të Gjermanisë (1995), në Galerinë e Arteve në Prishtinë (2001) etj. Skulpturat e tij janë ekspozuar në shumë ekspozita kolektive, si në Lubjanë (1971), në Bienalen IX të Aleksandrisë, Egjipt (1972), në Sallonin e Tetorit në Beograd (1973), në Bienalen e plastikës së vogël në Murska Sobota të Sllovenisë (1973), në Trienalen V të Artit Jugosllav në Beograd (1977), pastaj në ekspozitën e artit kosovar në Këln dhe në Paris, në ekspozitën e skulpturës jugosllave në Hungari, Rumani dhe Bullgari, në espozitën e artit bashkëkohor jugosllav në Australi dhe në Zelandë të Re, në manifestimin “Skulptura në ambientin e hapur” në Dyren të Gjermanisë, në ekspozitën “Artistët akademikë” në Galerinë e Arteve në Prishtinë (2002). Më 1994 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa më 1996 anëtar i rregullt. Është fitues i shumë çmimeve profesionale dhe mirënjohjeve publike, si: çmimi i gazetës “Borba”, Beograd (1969), çmimi “Franc Preshern” i Universitetit të Lubjanës (1971), çmimi i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (1972), çmimi i Sallonit Pranveror në Prishtinë (1981). (Luan Mulliqi)


ÇAVOLLI Liliana (1942-2015). Këngëtare e muzikës së lehtë dhe popullore. Lindi në Prizren. Pas shpërnguljes së familjes (1953), një pjesë të shkollimit e vijoi në Shkup, por u kthye sërish në Prizren, ku kreu shkollën e mesme të muzikës. Paraqitjen e parë publike e pati si anëtare e Shoqërisë kulturore-artistike “Agimi” në Prizren. Më pas kaloi në Prishtinë, ku e filloi karrierën prej këngëtareje e Radio-Prishtinës. Incizoi këngë në Radiotelevizionin e Prishtinës, në Radio Shkup si dhe me Orkestrën e Radiotelevizionit Shqiptar. Mori pjesë në



LILIANA ÇAVOLLI

Bashkëpunoi me kompozitorët: S. Kajtazi, Gj. Kaçinari, I. Muçolli. Këndoi në duete me M. Çavollin (e ëma), N. Pagarushën, B. Paçukun etj. I takon “brezit të artë” të këngëtareve që medializuan këngën dhe këngëtaresh shqiptare. Në vitet e fundit ishte redaktore dhe moderatore e emisioneve muzikore në Radio-Kosovë. (Indira Çipa)

ÇAVOLLI Riza (1930-). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Pejë, kreu gjimnazin në Prishtinë, ndërsa në Beograd mbaroi studimet universitare për gjeografi (1954). Një kohë



RIZA ÇAVOLLI

punoi si mësues në gjimnazin e Pejës, më vonë si këshilltar i gjeografisë në Entin Krahinor për Përparimin e Shkollave në Prishtinë. Në vitin 1970 zgjidhet ligjërues në katedrën e gjeografisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit, ku kreu edhe magistraturën në vitin 1972 dhe po aty në vitin 1975 e mbrojti disertacionin e doktoratës në temën “Rajoni i Dukagjinit - rajonalizimi fizionomik dhe nodalo-funksional”. Në vitin 1969 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Gjeografëve të Kosovës, pastaj ishte shefi degës së gjeografisë dhe në vitin 1975 ushtroi funksionin e dekanit të FSHMN-së. Është autor i një sërë librash studimorë dhe teksteve universitare, ndër të cilat do veçuar: “Gjeografia rajonale e Rrafshit të Dukagjinit” (1977) dhe “Gjeografia rajonale e Kosovës” (1997). Ka botuar edhe disa tekste të gjeografisë për shkollat fillore dhe të mesme. Është autor i shumë artikujve shkencorë-profesionalë, veçanërisht për strukturën dhe rajonizimin fizionomik të Kosovës. (Hivzi Islami)

ÇEÇANI. Fortifikatë shumështrësore dardane (antikiteti i vonë dhe periudha e hershme bizantine), e vendosur në kodrën e Çeçanit (728 m) ndërmjet fshatrave Duboc dhe Brusnik, 8 km në jugperëndim të komunës së Vushtrrisë. Pas vitit 1981 në këtë vendbanim janë bërë hulumtime të karakterit përnjohës, të cilat kanë rezultuar me krijimin e të ashtuquajturit “Thesari i Çeçanit” me rreth 150 artefakte të luajtshme. Këtij koleksioni i duhet shtuar edhe një mbishkrim glagolik kroat i ruajtur në një vazo qeramike (shek. IX-XI). Koleksioni i Çeçanit sot ruhet në Muzeun e Beogradit, si dhe në Muzeun Historik të Serbisë. Përveç artefakteve të luajtshme, në Çeçan është zbuluar nekropoli i ngritur në brendësi të fortifikatës së shkatërruar romake. Koleksioni i Çeçanit përbëhet nga monedha të periudhës së vonshme romake dhe të hershme bizantine: peshore, vula, fibula, pllaka të dekoruara nga kockat, stoli mesjetare (vathë dhe unaza), vegla të llojllojshme bujqësore, thika, latues (gdhendës) dhe gjashtë çelësa hekuri. Disa gjetje rasti, që përfshijnë periudhën rreth viteve 535-615, kanë analogji me gjetjet nga gërmimet sistematike shumëvjeçare në Caričin Grad (Leban, Serbi e sotme). Në koleksionin e artefakteve të Çeçanit gjenden edhe pjesë të enëve nga qelqi dhe qeramika. Nga 54 monedha, 28 prej tyre i përkasin shek. IV, të tjerat janë të periudhës së perandorëve bizantinë: Anastasi, Justini I, Justiniani dhe Justini II. Në lokalitetin e Çeçanit është gjetur edhe një tokëz bronzi e tipit Gepid (shek. V-VI), ndërsa stolitë mesjetare të Çeçanit datohen të periudhës së shek. IX-XI. (Jahja Drançolli, Hamdi Mediu)

ÇEKADA Ipeshkëv Smiljan (1902-1976). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Donji Vakuf (Bosnjë). Në vitin 1925 u shugurua prift. Disertacionin e doktoratës e mbrojti në Universitetin Papnor Gregorian të Romës (1928). Ushtroi detyra të ndryshme në Bosnjë (ipeshkëv, profesor e redaktor revistash). Më 1940, Selia e Shenjtë ia besoi udhëheqjen e Ipeshkvisë së Shkupit. Lufta e Dytë Botërore ia vështirësoi në masë të madhe detyrën ipeshkëvit. Mori në mbrojtje edhe hebrenjtë, disa prej të cilëve i strehoi nëpër famulli të Kosovës, për çka Izraeli e dekoroi pas vdekjes, në vitin 2011. Ishte i përndjekur dhe i persekutuar edhe gjatë kohës së komunizmit në ish-Jugosllavi. Pas Luftës së Dytë Botërore një kohë iu

besua udhëheqja e Ipeshkvisë së Banjallukës. U emërua edhe ndihmës i argjipeshkvit të Sarajevës (1967). Mori pjesë në Koncilin e Dytë të Vatikanit (1962-1965). Ipeshkvinë e Shkupit e udhëhoqi si administrator apostolik deri më 1970, duke u shquar sidomos për përgatitjen e klerit vendas. Vdiq në Sarajevë. (Sarë Gjergji)

ÇEKAJ Maxhun (1941-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Irzniq të komunës së Deçanit. Kreu shkollimin në Irzniq, në Prishtinë dhe në Gjakovë. Gjatë shërbimit ushtarak në Maribor të Sllovenisë kreu edhe shkollën për oficerë rezervë, ndërsa më vonë kreu Fakultetin e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Beograd. Nga viti 1962 deri më 1998 punoi në arsim. Me fillimin e luftës në Dukagjin iu bashkua radhëve të UÇK-së. U emërua komandant i shtabit lokal të UÇK-së për Irzniq. Për disa muaj Irzniqi ishte njëra ndër bazat e rëndësishme të UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit, ku ishte i vendosur spitali ushtarak dhe shumë të zhvendosur nga zonat e luftës. Ishte edhe përgjegjës i vijës së frontit në Gerdaja (ndërmjet Prilepit e Carrabregut). Më 11 gusht 1998, bashkë me 50-60 ushtarë të UÇK-së, u bënë ballë sulmeve të forcave serbe. Pas 12 orë luftimesh të rrepta, M. Çekaj ra heroikisht. (Manushe Ramosaj)

ÇEKAJ Sali (1956-1999). Luftëtar për çlirimin e Kosovës, Heroi i Kosovës. Lindi në fshatin Broliq të Pejës. Kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1981).



SALI ÇEKAJ

Punoi si gjykatës, më pas kryetar i Gjykatës Komunale në Deçan, si dhe në Gjykatën për Kundërvajtje në Deçan. Më 1990 u largua nga Kosova dhe emigroi në Gjermani, ku e vazhdoi aktivitetin në degën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë periudhës 1994-1997 hyri disa herë në Kosovë, në përgatitje të aksioneve të armatosura dhe për fillimin e luftës çlirimtare. Bashkë me grupet guerile që drejtonte, kreu disa sulme ndaj forcave serbe në territorin e komunës së Deçanit. Së bashku me Agim Ramadanin dhe bashkëluftëtarë të tjerë të Brigadës 138 dha një kontribut të rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e Luftës së

Koshares dhe mori pjesë në thyerjen kufirit Kosovë-Shqipëri në prill të vitit 1999. Ishte themelues i Brigadës 138 "Agim Ramadan". Ra heroikisht më 19 prill 1999, te vendi i quajtur Rasa e Koshares. Në prill të vitit 2016, me rastin e 17-vjetorit të betejës së Koshares, Posta e Kosovës ka vënë në qarkullim pullën postare me imazhin e S. Çekajt. Është dekoruar me Urdhrin "Hero i Kosovës" (Faton Mehmetaj)

ÇEKU Agim (1960-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ushtarak, politikan. Lindi në Qyshk të Pejës. Kreu shkollën e mesme ushtarake në Beograd, ndërsa studimet në Akademinë Ushtarake në Beograd dhe në Zarë të Kroacisë (1984). Ishte ligjërues dhe komandant i kompanisë së kadetëve në Akademinë Ushtarake në Zarë. Më 1992 mori gradën major. Gjatë operacionit "Xhepi i Medakut" (1993), si pjesë-



AGIM ÇEKU

marrës në luftën mbrojtëse të Kroacisë, u plagos rëndë. Në vitin 1995 u emërua shef i shtabit të distriktit ushtarak të Goshiqit. Komandoi forcat e këtij distrikti në operacionin "Stuhia", si dhe në operacionet sulmuese në Bosnjë deri në marrëveshjen e Dejtonit. Në shkurt të vitit 1999 u lirua nga ushtria kroate dhe iu bashkua UÇK-së. Në prill të vitit 1999 u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ndërsa në shtator të atij viti, pas demilitarizimit të UÇK-së, u emërua komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Më pas u kthye në jetën civile dhe më 2006 u zgjedh kryeministër i Kosovës. Më pas ishte kryetar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës dhe ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe, së fundi, deputet i Kuvendit të Kosovës. (Ali Uka)

ÇEKU Petrit (1985-). Kitarist. Lindi në Prizren, ku filloi edukimin muzikor në klasën e L. Sapunxhiut. Më 2002 kaloi në Zagreb, vijoi me prof. Xh. Sahatçiu. Më 2008 u diplomua në Akademinë e Muzikës në Zagreb (prof. D. Petrinjak). Në vitet 2009-2013 e rafinoi mjeshhtërinë prej kitaristi me M. Barrueco në Konservatorin "Peabody" në Baltimore (SHBA). Koncertoi me orkestrat "Allentown Symphony", "Baltimore Symphony", Filarmoninë Çeke, Filarmoninë e Kosovës, Orkestrën e Hermitazhit të St. Petersburgut, Orkestrën simfonike



PETRIT ÇEKU

të Radiotelevizionit Shqiptar dhe Filarmoninë e Zagrebit. Bashkëpunon me solistët e Zagrebit. Është bashkëthemelues i trios kitaristike “Elogio” (2008), i cilësuar si “solist i aftësive të larta”. Ka fituar një sërë çmimesh të para në garat ndërkombëtare, përfshirë “Parking Competition” në Malibu (SHBA, 2012). Është fitues në “Schadt Competition” në Allentown (SHBA, 2011), “Maurizio Biasini” në Bolonjë (Itali, 2011) dhe “Pittaluga Competition” në Alessandria (Itali, 2007). Konsiderohet ndër kitaristët më të mirë të brezit së tij. Incizimi i parë u lansua me etiketën amerikane “Naxos” (2008). Filarmonia e Zagrebit e shpërbleu me çmimin “Artisti i ri më i mirë” (2008). Më 2015, me etiketën spanjolle “Eudora Records” incizoi suitat për violonçel të J. S. Bach, aranzhuara nga V. Deshpali. Jeton në Zagreb dhe koncerton në skena të njohura ndërkombëtare. (Indira Çipa)

ÇEKU Skënder (1955-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Qyshk të Pejës. Pas gjimnazit në Pejë, kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë shërbimit ushtarak ndoqi shkollën ushtarake për oficerë rezervë në Zarë të Kroacisë dhe mori gradën e nëntogerit, më vonë të kapitenit. Për shkak të veprimtarisë politike ilegale, në vitin 1985 u burgos dhe u dënua me disa vjet burg. Pas daljes nga burgu, në revoltën e 31 janarit 1991 u plagos nga policia e Serbisë. Më pas emigroi në Zvicër, ku vazhdoi veprimtarinë për çlirimin e Kosovës. Në verën e vitit 1998 u kthye nga Zvicra në Shqipëri dhe që andej kaloi në Kosovë me bashkëluftëtarët e tij, duke u pozicionuar në fshatrat Raushiq, Loxhë e rrethinë. Përballja e tij e parë me forcat serbe ishte beteja e Loxhës (6 korrik 1998). Më pas u përball në betejat e vazhdueshme kundër forcave serbe, të cilat ndërmerrnin sulme të përditshme në këtë vijë të frontit. Veçohen betejat e 11 korrik dhe 15 gushtit të vitit 1998, kur forcat serbe sulmuan pozicionet e UÇK-së në Loxhë me artileri të rëndë, duke bombarduar edhe nga ajri, me avionë luftarakë. Në luftë e sipër, në lagjen e Morinëve, S. Çeku u plagos rëndë. U tërhoq nga fushëbeteja dhe u dërgua

në spitalin ushtarak në zonën e Malishevës, ku vdiq dy ditë më vonë. Më 2012 nga presidentja e Kosovës u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Teuta Shala-Peli)

ÇELA Bahri (1941-). Dirigjent dhe mësimdhënës. Pas Shkollës së Mesme të Muzikës në Prizren (1960), studioi dhe u diplomua në degën e dirigjimit në Akademinë e Muzikës në Beograd. Më pas kreu specializimin po në këtë degë (prof. A. P. Musin) në Konservatorin e Shën Petërsburgut (Rusi) dhe në Nicë (prof. P. Dervaux, F. Quatrocchi). Në Prishtinë ishte nismëtar i themelimit të Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Prishtinës (1975). Për një kohë të gjatë qe udhëheqës dhe dirigjent i saj, me të cilën realizoi koncerte me vepra kompozitorësh shqiptarë dhe të huaj. Punoi edhe producent i muzikës serioze dhe i asaj për fëmijë në Radio-Prishtinë. Disa vjet punoi edhe si dirigjent i korit të Shkollës së Mesme të Muzikës në Prishtinë, me të cilin pati paraqitje të suksesshme, duke fituar çmime e mirënjohje në garat e ish-Jugosllavisë. Nga viti 1978 ishte profesor për lëndët dirigjim dhe orkestrë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve '90, megjithë situatën e rëndë politike, bashkë me studentët, korin dhe instrumentistët e orkestrës së Radiotelevizionit të Prishtinës arriti të organizojë disa koncerte, përfshirë një koncert-homazh kushtuar Nënë Terezës. Pas luftës në Kosovë iu kthye punës si profesor në Fakultetin e Arteve dhe u angazhua për riaktivizimin/themelimin e orkestrës si institucion i pavarur (sot Filarmonia e Kosovës) dhe për disa vjet ishte dirigjent i saj. (Kristina Palokaj-Përkola)



BAHRI ÇELA

ÇELA Raif (1963-). Veprimtar, bashkëthemelues i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Lindi në fshatin Rashan të Mitrovicës. Që në moshën e hershme filloi të merrej me veprimtari politikë ilegale. Ishte vetëm 16-vjeçar, kur më 1979 u arrestua për herë të parë nga policia serbe. Për shkak të veprimtarisë së organizuar ilegale, më 1984 u arrestua dhe u dënua me 12 vjet burg. Më 1993 bënte pjesë në grupin që themeloi Lëvizjen

Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Vetëm pas tre vjetësh jashtë burgut, R. Çela u arrestua sërish dhe u dënua me 10 vjet burg. Gjithsej i ka kaluar mbi 14 vjet në burgjet e ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë. Më 1993 ishte kryeredaktor i parë i revistës ilegale “Çlirimi”. Ishte nga të mbijetuarit e masakrës në Burgun e Dubravës në maj 1999. U lirua nga burgu më 2001. Në vitin 2014 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja për Bashkim. (Sabit Sylja)

ÇELAJ Agim (1961-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Pejë, ku kreu edhe shkollën e mesme. Kreu studimet në Akademinë e Përgjithshme Ushtarake në Beograd dhe në Zarë të Kroacisë, në degën e artilerisë raketore. Si oficer i ushtrisë jugosllave shërbeu për disa vjet në Kroaci. Me fillimin e luftës në Kroaci, në marrëveshje me forcat mbrojtëse kroate, në janar të vitit 1992 i tërhoqi ushtarët shqiptarë që gjendeshin në kazermë në ujdhesën e Visit, ku ai shërbente. Pas luftës së Kroacisë emigroi në Gjermani, që andej u kthye në në Shqipëri dhe në maj të vitit 1988 hyri në Kosovë. Nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së iu dha detyrë të bënte përgatitjen e njësiteve speciale për reagime të shpejta. Mori pjesë edhe në beteja, si në Llapushnik, në Jashanicë, për mbrojtjen e Kodrës së Hotit etj. Ishte përgjegjës edhe në shumë vija të frontit në Zonën Operative të Drenicës dhe në Zonën Operative të Pashtrikut, si në Açarevë, Llaushë, Kleçkë etj. Në korrik të vitit 1998 u vu në ballë të njësiteve të UÇK-së për evakuimin e popullatës civile dhe mbrojtjen e Rahovecit. Ra heroikisht më 19 korrik 1998 gjatë sulmit të katërt të ushtrisë serbe. Në vitin 2013 nga presidentja e Kosovës u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Manushe Ramosaj)

ÇELAJ Lirak (1973-). Aktor, dramaturg. Lindi në Prishtinë. Në vitin 1995 mbaroi aktrimin në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 1999-2002 ishte drejtor i përgjithshëm i Teatrit Kombëtar. Nga viti 2003 bashkëthemeloi Teatrin “Oda”. Në vitin 2012 u zgjodh kryetar i Unionit të Artistëve të Filmit të Kosovës. Përveç aktrimit, shkruan edhe drama dhe skenarë televizivë. Dramat “Moti pa ton” dhe “Tre gjermanët e trashë” janë vënë në skenë në Teatrin “Oda”. Po ashtu u paraqit edhe si skenarist me komeditë televizive në Radio-televizionin e Kosovës dhe Televizionin “Top



LIRAK ÇELAJ

Chanell” të Tiranës. Që kur ishte fëmijë luajti në filmin televiziv “Fidani”, i realizuar nga Radio-televizioni i Prishtinës në vitet ’80. Luajti edhe në seritë televizive “Lagjja e re” dhe “Jeta e një toke”. Në vitin 1993, si aktor debutues luajti në Teatrin “Dodona” me komedinë “Profesor jam talent se jo mahi”. Në vitin 2014 me komedinë “Bark tupani” të R. Dormer, u sprovua edhe si regjisor teatri. (Jeton Budima)

ÇELAJ Sylejman (1970-). Mjek, internist, kardiolog, mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë “Albert Ajnshtajn” në Nju-Jork, SHBA. Lindi në Gjakovë. U diplomua në Fakultetin Mjekësisë të Universitetit të Krakovës në Rumani (1995). Në vitin 1996 shkoi në Amerikë, ku fillimisht punoi në Kolegjin e mjekësisë “Albert Ajnshtajn” në Nju-Jork. U specializua për mjekësi interne dhe u sub-specializua për kardiologji dhe kardiologji invazive. Punon në spitalin Montefiore dhe është drejtor i departamentit të kardiologjisë invazive në spitalin “St Barnabas” në Bronks të Nju-Jorkut. Gjithashtu është asistent-profesor në Fakultetin e Mjekësisë “Albert Ajnshtajn”, anëtar i Kolegjit Amerikan të Kardiologjisë etj. Është autor i shumë punimeve shkencore të botuara në revista të njohura dhe ka marrë pjesë në takime të kardiologëve në vende të ndryshme të botës. Është bashkëkryetar i Shoqatës së Mjekëve Shqiptaro-Amerikanë, themeluar në vitin 2008. (Ismajl Dreshaj)

ÇELAJ Zenun (1940-). Gazetar. Lindi në Vuthaj, në Mal të Zi. Katër klasat e para të fillores i mbaroi në fshatin e lindjes, katër të tjera në Guci. Shkollën Normale e kreu në Prishtinë,



ZENUN ÇELAJ

ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Nisi punën si gazetar në të përditshmen “Rilindja” në vitin 1960. Nga atëherë deri në mbyllje të saj nga Serbia në gusht të vitit 1990, si dhe në gazetat që e pasuan më vonë, ushtroi detyrat e gazetarit, të reporterit, të komentatorit, të redaktorit dhe

ndihmësit të kryeredaktorit. Ishte ndër themeluesit dhe kryeredaktori i gazetës së parë të studentëve të Prishtinës “Bota e re”, ndërsa ka qenë bashkëpunëtor dhe anëtar shumëvjeçar i redaksisë “Zani i rinisë”. Ishte gjithashtu kryeredaktor i parë i të përditshmes “Zëri”, pas luftës, nga viti 2000, ndërsa nga viti 2009 është kryeredaktor i portalit “Koha.net”, në kuadër të Grupit “Koha”. U mor me përgatitjen e shumë brezave të gazetarëve në “Rilindje”, “Zëri”, “Kohën ditore” dhe në kuadër të Institutit të Mediave të Kosovës. Gjatë punës në gazetari ka raportuar për ngjarje me rëndësi për vendin, siç ishin demonstratat e viteve 1968 e 1981 dhe për protestat gjithëpopullore të viteve 1988-89, pastaj për grevën e minatorëve të “Trepçës” më 1989, për shpalljen e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut nga Kuvendi i Kaçanikut më 1990. Ishte ndër themeluesit e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe sekretar shumëvjeçar i tij, si dhe pjesëmarrës në kuvendin themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (1989). Për punën në gazetari mori çmime dhe mirënjohje. Përktheu nga gjuha serbokroate në shqip veprat e Zuvdija Hoxhiq-Berishës “Viti i Gucisë” dhe “Dimri” etj. (Artan Krasniqi)

ÇELEBIU Ashik (1529-1572). Poet me origjinë nga Prizreni. Emri i tij i vërtetë ishte Pir Mehmeti. Sikurse i ati i tij, Aliu, pasi kreu studimet në Stamboll, punoi si kadi në shumë qytete të Perandorisë Osmane, ndër të tjera edhe në Prishtinë. Njihet si poet dhe përkthyes nga gjuha arabe dhe gjuha perse. Ka shkruar shumë poezi. Vepra e tij më e rëndësishme është “Antologji e poetëve” e botuar në vitin 1568. Vdiq më 1572 në Shkup, ku edhe u varros. (Irfan Morina)

ÇELEBIU Evlija (1611-1682). Kronist dhe udhëpërshkruesi më i madh i shekullit XVII. Lindi në një familje bujare të Stambollit. Kishte studiuar për teologji. Në vitin 1636 sulltan



EVLIJA ÇELEBIU

Murati IV e ftoi në sarajin perandorak, ku qëndroi deri në fund të sundimit të tij. Nga viti 1640, për katër dekada me radhë, udhëtoi përgjatë tri kontinenteve të Perandorisë Osmane dhe përtej saj, duke qenë pjesëmarrës dhe dëshmitar i një sërë fushatash në Azov, Kretë, Vllahi, Moldavi, Dalmaci, Mal të Zi, Hungari,

Austri etj. Llogaritet se gjatë udhëtimeve kaloi jo më pak se 350,000 kilometra rrugë. Shënimet e udhëtimeve i përmbledhi në veprën “Seyâhatnâme” (Libër/Kronikë udhë-timesh), në 10 vëllime. Mbi dy dekada të udhëtimeve të tij Evlija Çelebiu ia kushtoi Ballkanit. Shënimet, sidomos mbi qytetet, i gjejmë të shpërndara në pjesën më të madhe të veprës së tij. Njoftime të vlefshme la edhe për krahinat dhe qytete shqiptare, përfshirë edhe Kosovën. Viset shqiptare i vizitoi disa herë, por shënime më të hollësishme gjejmë sidomos në vëllimet V (1660), VI (1662) dhe VIII (1670). Më 1660 ai ka kaluar nëpër Kosovë, duke qëndruar në Zveçan, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë dhe Kaçanik, pastaj në Shkup, ndërsa më 1662 ka vizituar një pjesë të madhe të Shqipërisë: Elbasan, Tiranë, Mamurras, Lezhë, Spas, Gjakovë, Bushat, Shkodër, Ulqin, Tivar dhe më tej Budva, Podgoricë; në vitin 1670 ai edhe një herë ndodhet në viset shqiptare, këtë herë në jug: Elbasan, Peqin, Kavajë, Durrës, Bashtovë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Gjirokastrë, Delvinë e më tej në Greqi. Ndër shënimet e ndryshme për jetën ndër shqiptarë, Çelebi ka lënë dhe disa shprehje shqip. (Gazmend Rizaj)

ÇELIKU Arbër (1974-). Gjuhëtar, gjermanist, përkthyes. Lindi në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi gjermane i mbaroi në Universitetin e Tetovës. Studimet e doktoratës i vazhdoi në Universitetin e Mannheimit, ku më 2007 mbrojti disertacionin për koherencën e tekstit në shqipe dhe gjermanishte. Aktualisht është profesor i Universitetit të Tetovës, ndërsa kreu edhe funksione drejtuese në këtë institucion të arsimit të lartë. Është themelues i revistës “Filologjia” të Universitetit të Tetovës. Nga viti 2011 është anëtar i Bordit të Agjencisë së Akreditimit të Republikës së Maqedonisë. Botoi artikuj studimorë dhe tekste universitare. Ka përkthyer një sërë librash nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe të autorëve Hese, Kelman, Ceh, Frish, Habermas, Adorno, Ueber etj. (Milote Sadiku)

ÇELIKU Kalosh (1951-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Cërvicë të Kërçovës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Normalen në Shkup, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues në Drenicë e Malësi të Shkupit. Nga viti 1992 drejton Shtëpinë Botuese “Asdreni” në Shkup dhe revistën për humor e satirë “Zekthi”. Shkruan poezi e prozë për

fëmijë e të rritur. Ka botuar mbi dyzetë libra me poezi, tregime, drama, romane: “Zogu erdhi me një këngë” (1982), “Lepuri me pushkë” (1983), “Shtëpiza e xixëllonjave” (1984), “Ferexhja e zezë” (1985), “Arusha pa bisht” (1986), “Dielli zbret maleve” (1986), “Varrimi i sorrave” (1988), “Vite me borë” (1990), “Imzot, lehin qentë” (1993), “Sorraku i qytetit” (1994), “Loja e syve” (1995), “Babi ka dy nuse” (1995), “Qyteti i qyqeve” (1997), “E përçolla Natën” (1998), “Mbrëmë fjeta me Vjeshtën” (1999), “Kopeja me zgjebe ndjek Autorin” (2000), “Shtëpia publike” (2000), “Lamtumirë bërllok” (2002), “Vdekja më deshi më pak se Ti” (2003), “Repriza e vëllazërim – bashkimit” (2005), “Atdheu ky burrë pa Grua” (2006), “Engjëlli im është Grua” (2007), “Dimri, s’vjen me lule” (2007), “Ujku e di një lojë” (2007), “Gruaja besnike” (2009) etj. Është fitues i disa çmimeve letrare për poezi, tregim e pjesë teatrore. Krijime të tij janë përkthyer në disa gjuhë. (Xhevat Sylja)

ÇERKEZËT. Popull që jeton në Republikën e Çerkezisë, në kuadër të Federatës së Rusisë, në veriperëndim të Kaukazit, në lindje të Detit të Zi. Emri çerkez rrjedh nga fjala Kerketi, pasardhës të adigejve antikë. Çerkezët janë përshkruar si popull krenar, luftëtarë dhe të qëndrueshëm. Historia e vjetër e çerkezëve është relativisht e panjohur. Gjatë periudhës mesjetare, përkatësisht në shek. XII-XIII ata kishin autonominë e tyre. Më pas ranë nën sundimin e Gruzisë, kur pranuan krishterimin. Më 1555 ranë nën sundimin e perandorit rus Ivan Grozni. Më vonë, gjatë pushtimit tatar, çerkezët pranuan islam, e, së fundi, ndonëse i bënë qëndresë të fortë autoriteteve ruse të Kaukazit, ranë nën sundimin e tyre (1857-1864). Atëherë rreth 400,000 çerkezë u shpërngulën në Perandorinë Osmane, rrjedhimisht në Azinë e Vogël, Maqedoni dhe në Kosovë. Në Luftën Ruso-Osmane (1876-1877) çerkezët morën pjesë përkrah ushtrisë së Perandorisë Osmane. Një pjesë e madhe e çerkezëve që jetonte në Kosovë u shpërngul në Perandorinë Osmane pas Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913). Një pakicë, që vazhdoi të jetonte në Kosovë, ka ruajtur gjuhën e traditën. Çerkezët sot jetojnë edhe në Turqi, Siri, Jordani etj. (Ramiz Abdyli)

ÇERKEZI Marigona (1993-). Soprano dhe flautiste. Lindi në Zagreb, ku kreu shkollën e mesme të muzikës dhe më pas u diplomua në

flaut dhe solokëndim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Specializoi në Kroaci dhe Rusi, mori një sërë mirënjohesh dhe në kuadër të “Jeunesses Musicales Junior Orchestra” performoi në Shqipëri, Itali, Holandë, Spanjë, Gjermani, Angli, SHBA etj. Është fituese e një sërë konkursesh dhe bëri një sërë prezantimesh të suksesshme. Interpretoi role në operat “Flauti magjik” në Muscat Royal Opera House, “Kontesha e Almavive” në TOB Tiranë, pastaj me “Martesa e Figaros” në Teatro lirico di Cagliari, në Pesaro Rossini Opera Festival me Madame Cortese nga opera “Udhëtimi në Reims” të Rosinit, në Teatro Petruzelli-Bari me rolin e Lucias në operën “Lucia of Lammermoor” të Donizettit, si dhe me Rosalindën nga operetta “Die Fledermaus” të Strausit, në Grand Theatre Barcelona me Madame Cortese nga “Udhëtimi në Rems” etj. Gjithashtu është prezantuar në festivale dhe manifestime të ndryshme në Moskë, Komo, Milano, Zagreb, Parma, Pesaro, Amsterdam, Bon, Bruksel, si dhe në festivalet vendore. (Zeqirja Ballata).

ÇERKEZI Omer I. (1919-1954). Politikan, drejtor i “Rilindjes” më 1946. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, gjimnazin në Shkup. Studioi për bujqësi dhe pylltari në Beograd. Mori pjesë në lëvizjet revolucionare qysh si student. Gjatë viteve 1940-1941 ishte i internuar si pjesëtar i lëvizjes komuniste. Më 1941 udhëhoqi Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ) në rrethin e Mitrovicës, pastaj në Kollashin të Ibrit formoi aradhen partizane. Në korrik të vitit 1942 u arrestua nga forcat italiane, të cilat ua dorëzojnë forcave bullgare, prej nga arrin të arratiset. Në fund të vitit 1942 i bashkohet LNÇ-së në Bosnjë, ku kapet nga forcat gjermane, të cilat e internojnë në Gjermani. Më 1945, pas përfundimit të luftës, u kthye në Kosovë. Ushtri funksione politike në Prishtinë dhe Mitrovicë. Ishte drejtor i “Rilindjes” më 1946. Më 1948, bashkë me Xheladin Hanën, Rifat Berishën dhe Faik Pruthin krijojnë në Prishtinë organizatën “Fronti Kombëtar”. U burgos më 1948. Vuajti dënimin në burgun e Goli Otokut deri më 1951. Dy vjet më pas u burgos sërish. Më 1954, po në burgun e Goli Otokut, i humbet çdo gjurmë. (Zenun Çelaj)

ÇERKEZI Nexhmije (1974-). Grafiste. Lindi në Prishtinë, ku kreu gjimnazin dhe Fakultetin

e Arteve, drejtimi i grafikës (2004). Krijimtaria e saj u realizua me teknikën e akuatintës. Viteve të fundi aplikon shtypin digjital. Shquhet cikli i punimeve “Vallëzimi mbi ujë”. Organizoi tri ekspozita personale: më 2014 në “Qendra Kulturore të Kosovës” në Stamboll, më 2007 në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë dhe në Qendrën për Kulturë në Gostivar. Është pjesëmarrëse në ekspozita të përbashkëta ndërkombëtare, anuale, bienale e triennale të grafikës: në Ekspozita II të Grafikës në Stamboll (2006), në “Expo 07” Gana (2007), në Bienalen e Grafikës në Varna (2007 dhe 2009), pastaj në Anualin VI dhe VII të grafikës në Lesedra të Sofjes (2007, 2008), në Bienalen e grafikës së vogël amerikane në Austin (2008, 2010), në Bienalin Ndërkombëtar të Grafikës në Miniaturë në Czestochow, Poloni, si dhe në Uashington, Barcelonë, Londër, Paris, Majami, Stamboll, Tokio, Tiranë etj. Mori çmimin “Femrat krijuese” në Gjilan (2004) dhe çmime e mirënjohje të tjera. (Fatmir Krypa)

ÇERKEZISHTJA. Gjuhë e çerkezëve kaukazanë, e grupit dige, që bën pjesë në degën e familjes së Kaukazit Perëndimor (apo Veri-Perëndimor). Ka dy dialekte: dialektin çerkez lindor apo kabardin (që shtrihet në qarkun Kabardi-Balkar në Kaukaz) dhe dialektin çerkez perëndimor, khjasku, i cili paraqet kryesisht gjuhën me po këtë emër, që është folur dikur në tërë zonën e stepave, në jug të Kubanit. Në vitin 1865 çerkezët mërguan në Turqi dhe Siri. Sot flitet në ish-republikat e Bashkimit Sovjetik, në Gjeorgji dhe në Turqi, e në bashkësi më të vogla edhe në Lindjen e Afërt. Në atë kohë çerkezët kanë ardhur edhe në Kosovë dhe janë vendosur afër Vushtrrisë (fshati Stanoc), ku kanë jetuar deri pak para luftës së fundit. (Jahja Hundozi)

ÇERSHKOV (Čerškov) Emil (1929-1969). Arkeolog. Lindi në Siveriq (Dalmaci) dhe studimet i kreu në Universitetin e Beogradit, ku edhe mbrojti disertacionin (1965). Punoi në Muzeun e Kosovës (1954-1968) dhe për një kohë ishte edhe drejtor i tij, duke e ngritur atë në një institucion të rëndësishëm shkencor dhe kulturor. Organizoi dhe realizoi rekognosimin e parë arkeologjik në Kosovë. Themeloi dhe redaktoi revistën e parë shkencore në Kosovë “Buletini i Muzeut të Kosovës”. Udhëhoqi gjurmimet e para sistematike të periudhës romake

të realizuara në Kosovë, duke vendosur edhe bazat e studimeve të kësaj periudhe. Me emrin e tij lidhet edhe zbulimi i dy vendbanimeve të rëndësishme me rang municipal, Ulpianës dhe Municipium DD. Është autor i monografisë “Municipium DD” (1970) dhe i studimit “Romakët në Kosovë e Metohi” (1969), si dhe i një numri studimesh shkencore të botuara në revista të ndryshme. (Arben Hajdari)

ÇETTA Anton (1920-1995). Shkrimtar, mbledhës i folklorit, studiues. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e nisi në Prizren dhe e vazhdoi më vonë në Tiranë, ku filloi edhe shkollimin e



ANTON ÇETTA

mesëm, të cilin e vazhdoi në Liceun e Korçës dhe pastaj edhe në Liceun Klasik të Milanos. Më 1941 u kthye në Prizren dhe punoi si nëpunës poste dhe më pas si mësime në gjimnazin e Prizrenit. Ndoqi studimet universitare në romanistikë në Universitetin e Beogradit, ku punoi një kohë si asistent në degën e albanologjisë. Së bashku me Vojislav Dançetoviçin dhe Kadri Halimin përgatiti tri vëllime këngësh popullore të mbledhura në Kosovë. Më pas u kthye në Prishtinë, ku u emërua mësime në lëndëve letërsia e vjetër shqiptare, histori e letërsisë dhe gjuhë latine. Në vitin 1968 kaloi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku udhëhoqi degën e folklorit. Shkroi edhe poezi për fëmijë, hartoi tekste shkollore dhe përkthyer vepra të ndryshme letrare. Që nga vitet '50 deri në fillim të viteve '90 përgatiti për botim një sërë veprash me njësi folklorike nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Për shumë vjet në Kosovë, mbledhja, arkivimi dhe botimi i folklorit u lidh me emrin e tij. Në materialet e mbledhura nga dora e tij gjenden këngë kreshnike, balada, këngë historike, këngë dasmash, përralla, anekdota, gjëgjëza etj. Ishte edhe studiues i krijimeve dhe zhanreve të ndryshme gojore. Si autor dhe bashkautor botoi një sërë veprash nga kjo fushë: “Këngë popullore të Kosovës-Metohisë” (1952-53), “Nga proza popullore e Drenicës”, I-II (1963), “Balada dhe legjenda” (1974), “Këngë kreshnike” (1974), “Përralla” (1982), “Nga folklori ynë” (1983), “Kërkime folklorike” (1981), “Anekdota” (1987). Në

vitin 1955 botoi përmbledhjen e poezive për fëmijë "Në prehën të gjyshes". Në vitet '90 u bë i njohur si njeriu i urtë i pajtimit të gjaqeve, kur u zgjodh kryetar i Këshillit Qendror të Lëvizjes Kombëtare për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë. Nën udhëheqjen e tij u pajtuan me mija familje shqiptare. Për aktivitetin kulturor, studimor e nacional A. Çetta u nderua me çmime dhe mirënjohje të shumta. (Kujtim Rrahmani)

ÇIÇAVICA. Mal midis dy fushëgropave, të Drenicës në perëndim dhe të Kosovës në lindje, një zonë kryesisht kodrinore, lidhëse midis tyre. Paraqitet në formë të kurrizit kodrinor me gjatësi rreth 24 km, midis grykës së Ibrit në veriperëndim dhe të Drenicës nga juglindja, me gjerësi 2-6 km dhe lartësi 700-1,000 m (Maja e Stanicës 1,095 m), duke qenë njëherësh kufi morfotektonik midis këtyre dy fushëgropave. Në aspektin tektonik, Çiçavica paraqet një horst ndërmjet fushëgropave, të cilat janë krijuar përmes shkëputjeve vertikale (normale). Është e ndërtuar kryesisht nga formacioni sedimentaro-vullkanik i triasikut, ultrabazikët, flishi i kretakut etj. Të kushtëzuara nga thyerjet tërthore janë formuar lugina, disa në trajtë të grykave (Brusnikut), duke i dhënë Çiçavicës trajtë bllokore, me diferencim të blloqeve nga 150-200 m. Në aspektin morfotektonik, paraqet një monoklinal. Mbulesa bimore përfaqësohet gati tërësisht nga kati i dushkut. (Shpejtim Bulliqi)

ÇIMOHOVSKI Vaclav (Wacław Cimocho-wski) (1912-1982). Filolog, indoeuropianist, albanist polak. Studimet indoeuropiane i ndoqi nën drejtimin e indoeuropianistit Jan Otrębski, pastaj te Paul Kreçmeri, te Nikolai S. Trubeckoi e te Norbert Jokli në Vjenë, ku u fut në rrethet e studimeve albanologjike. U mor me studimet krahasimtare indoeuropiane dhe në mënyrë të veçantë me studimet e shqipes. Me emrin e Çimohovskit është e lidhur tradita albanistike e shekullit XX në Poloni. U shqua me botimet për gjuhën shqipe në revistën "Lingua Posnaniensis". Veprimtaria e Çimohovskit u zhvillua në dy drejtime: në studimet e shqipes së sotme dhe në hulumtimet diakronike. U mor edhe me përhapjen e dijes për shqipen dhe shqiptarët në Poloni, shkroi artikuj të ndryshëm për letërsinë shqiptare nëpër botimet enciklopedike etj. Me recesionet e tij dhe sidomos me studimin e gjerë mbi

sand'hin në gjuhën shqipe, Çimohovski iu ra në sy albanologëve menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Afirmimin e plotë e arriti me botimin e monografisë për të folmen e Dushmanit, që e botoi frëngjisht më 1951 në Poznanj. U mor me çështje të historisë së gjuhës shqipe. Një aspekt me rëndësi në studimet e tij për gjuhën shqipe është ai i prejardhjes së saj. Botoi disa studime substanciale: "Prejardhja e gjuhës shqipe" (1958), "Hulumtime për toponomastikën e Shqipërisë" (Des recherches sur la toponomastique de l'Albanie, 1960), "Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoeuropiane" (1973) etj. Vepra shkencore e V. Çimohovskit ("Për gjuhën shqipe") është botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në vitin 2004. (Kadire Binaj)

ÇIPO Omer (1928-). Agronom. Lindi në Prizren. Shkollën e mesme bujqësore e kreu në Prishtinë, Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Sarajevës (1957). I takon gjeneratës së parë të agronomëve të diplomuar shqiptarë. U punësua agronom në Suharekë, ku mori pjesë në ngritjen e plantacioneve të vreshtave dhe pemëtoreve. Që nga themelimi i Kombinatit bujqësor-industrial (KBI) "Progres-Export" në Prizren, deri në vitin 1961, punoi agronom e më vonë mësimdhënës i shkollës së mesme bujqësore në Prizren (Landovicë). Emërohet drejtor i stacionit për zhvillim të KBI "Progres-Export" në Prizren, drejtor i përgjithshëm i këtij kombinati dhe kryetar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit (1974-1978). Më pas emërohet sekretar Krahinor për Bujqësi (1979) dhe sërish drejtor i KBI "Progres-Export" në Prizren. Kreu edhe funksione të tjera në institucionet e pushtetit vendor dhe qendror të kohës së ish-Jugosllavisë. O. Çipo ka merita për zhvillimin e bujqësisë dhe të ekonomisë, sidomos në zhvillimin e vreshtarisë dhe verërisë në Kosovë. (Latif Susuri)

ÇIRINÇONE Anxhela (Angela Cirrincione) (1926-2008). Gjuhëtare italiane. Studioi për letërsi klasike në Universitetin e Palermos, ku për temë disertacioni pati "Një vështrim mbi manualin e gjuhës shqipe të August Dozonit". Punoi si asistente në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Palermo. Më vonë vazhdoi në katedrën e filologjisë gjermane në Universitetin e Palermos. U shqua në studimet e gramatikës së shqipes, të sociolinguistikës, të etnolinguistikës

etj. Botoi veprën “Sintaksë shqip e shkrimtarëve të vjetër” (Sintasi Albanese degli antichi scrittori, Romë 1968). Në fushën e letërsisë botoi: “Bernardin Palaj - Vepra I, Poezi” (Romë 1968), “Poezia e Jakova-Merturit”, “Shëjzat”, nr. 2-3 (Romë, 1957) etj. (Imri Badallaj)

ÇITAKU Erëmira (1976-). Flautiste. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme të muzikës. U diplomua në degën e flautit më 2001 në Fakultetin e Arteve të Uni-



ERËMIRA ÇITAKU

versitetit të Prishtinës. Më 2003 u specializua në fushën performuese në flaut në “Ecole Normale de Musique” në Paris. Në Universitetin e Ri Bullgar, më 2008 u promovua magjistre për flaut klasik dhe xhaz.

Më 2014, po aty, mori

titullin doktore e flautit klasik. Aktivitetet koncertale solistike: turneu koncertal në Kosovë më 2002, në Bergen-Norvegji (2003), Paris (2006), Sofje (2006), Prishtinë (2009), pjesëmarrje në festivalin “Tingujt e flautit” (2010) dhe koncert në “Lemmens Institute-Join EUS-EE” (Belgjikë). Më 2011 soliste me Ansamblin “R. Mulliqi” në Prishtinë e në Francë, më 2012 në Galerinë “Uniart”, si dhe me orkestrën “Orfei” (Bullgari). Mori pjesë në koncerte kolektive në Shqipëri, Angli, Zvicër, Francë, Turqi, Bullgari, SHBA. Është autore e librit multimediale “Shoshë” (2011). Në “Concours de flute Roger Bourdin” në Paris fitoi çmimin III (2003), në Garat “Muzika e bota” në Sofje mori çmimin special. Është asistente e flautit në Fakultetin e Arteve dhe drejtore e festivalit “Tingujt e flautit”. (Indira Çipa)

ÇITAKU Faik (1942-). Profesor universiteti në fushën e sportit. Lindi në Bajçinë të Podujevës. Kreu Fakultetin e Kulturës Fizike në Sarajevë, studimet e pasuniversitare në



FAIK ÇITAKU

Zagreb, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1985). Ishte gjyqtar ndërkombëtar i pingpongut nga viti 1977 deri më 1981, trajner i klubit të hendbollit “Prishtina” (për meshkuj dhe

femra), përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës në hendboll, trajner i skuadrës së pingpongut “7 Shtatori” të Prishtinës. Në Fakultetin e Kulturës Fizike nisi të punojë që nga themelimi (1979/80) dhe u avancua në të gjithë titujt universitarë. Ka marrë pjesë në shumë gara ndërkombëtare të hendbollit dhe të pingpongut. Është autor i disa librave nga fusha e sportit dhe i veprave shkencore nga kjo fushë: “Hendbolli-stërviija sportive”, “Sistemi i garave në Kosovë”, “Kriteret për stimulimin e sportistëve cilësorë të Kosovës”, “Kategorizimi i sportistëve të Kosovës”, “Kronologjia e pingpongut në Kosovë” etj. (Albatri Matoshi)

ÇITAKU Jeta (1986-). Soprano. Mësimet e para muzikore për violinë i mori në Shkollën e Ulët të Muzikës në Prishtinë. Kreu studimet në drejtimin e solokëndimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, te prof. Merita Juniku. Ka interpretuar role të shumta, si ai i Violetës nga opera “La Traviata” etj. Ka mbajtur masterkursa me emra të njohur të skenës operistike, si: N. Mula, J. Gjipali, V. Brunetti, I. Konzulov, B. Wittelsberger. Më 2006 koncertoi me dirigjentin Simon Deshpali në Prishtinë. Më 2008 në koncertin solistik “Mbrëmje verdiane” në Prishtinë interpretoi arie nga operat “Ballo me maska”, “Nabucco”, “La Traviata”, “Rigoletto”. Si soliste është paraqitur me Orkestrën e Filarmonisë së Kosovës në festivalet “Fryma e re DAM” etj. Bashkëpunon me Orkestrën “Rexho Mulliqi”, paraqitet si soliste në Paris, Prishtinë dhe në qytete të tjera në Kosovë. Veçohen bashkëpunimet aktuale në masterkursin te Ivan Konzullovi në Cyrih dhe Strasburg, me Irene Cordelia Huberti (pianiste) në operën e Strasburgut dhe me mezosopranon Judith Gauthier. (Besa Luzha)

ÇITAKU Nehat (1963-). Pingpongist, trajner. Karrierën si pingpongist e filloi në Prishtinë, ndërsa gjatë gjithë veprimtarisë së tij ishte ndër më të mirët në Kosovë. Ka qenë aktiv në pingpong që nga viti 1975. Ishte kampion i Kosovës për të rinj (1980) dhe seniorë (1983, 1992/93), dy herë pjesëmarrës i turneut “TOP 12” në ish-Jugosllavi, pjesëmarrës dhe organizator në të gjitha aktivitetet e Federatës së Pingpongut të Kosovës (FPPK) gjatë periudhës 1991-1999, kampion i Shqipërisë (1999), anëtar i përfaqësueses së Kosovës në ndeshjen e parë

të saj (2001), përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës (2002-2009), udhëheqës i përzgjedhjeve të Kosovës në kampionatet botërore për seniorë (Doha, Katar 2004; Shangai, Kinë 2005; Bremen, Gjermani 2006; Zagreb, Kroaci 2007; Guanzhou, Kinë 2008; Yokohama, Japoni 2009; Rotterdam, Holandë 2011 dhe Dortmund, Gjermani 2012), në kampionate europiane për seniorë (Danimarkë, 2005; Çeki, 2010 dhe Poloni, 2011). Ishte nismëtar i procesit për njohjen ndërkombëtare të pingpongut nga ITTF-ja dhe ETTU-ja, organizator kryesor i dy turneve kualifikuese për Kampionatin European në Prishtinë më 2005 dhe 2006. Është gjyqtar ndërkombëtar i pingpongut që nga viti 2012. Ishte kryetar i FPPK-së. (Bekim Aliu)

ÇITAKU Shaip (1944-). Grafist. Lindi në Bajcinë të Podujevës. Shkollën Normale dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e arteve figurative, i kreu në Prishtinë. Më pas kreu



SHAIP ÇITAKU

studimet në Akademinë e Arteve, drejtimi i grafikës, po në Prishtinë (1977). Organizoi disa ekspozita personale, nga të cilat tri në Prishtinë, një në Beograd, një në Grozhnjan dhe dy në Melburn të Australisë. Është pjesëmarrës në shumë ekspozita të përbashkëta në vend dhe jashtë, siç është ekspozita e grafikës së krijuesve kosovarë në Malmo (Suedi) (1983), pastaj në Gllasgou (Skoci) dhe në Belfast (Irlandë) (1985), në Bienalen XIV dhe XVIII të Grafikës Ndërkombëtare në Lubjanë, në ekspozitën e grafikës bashkëkohore botërore në Kore dhe në Japoni (1987), në Bienalen Ndërkombëtare të Grafikës në Mastriht (Holandë) (1993), në ekspozitën “Arti Bashkëkohor i Kosovës” në Kajro etj. Është fitues i disa çmimeve për grafikë dhe vizatim, si: çmimi për grafikë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1979), çmimi i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Bosnjës e Hercegovinës (1982), çmimi për grafikë në ekspozitën XVI të Grafikës Jugosllave në Zagreb (1990), pastaj në Sisak, “Çmimi i Hekuranës” etj. Krijimtaria e Sh. Çitakut karakterizohet me shprehjet kompozicionale gjeometrike të teksturuara në kuadër të grafikës si art i zi. Ishte mësimdhënës i lëndës së grafikës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë deri në pensionim. (Basri Mekolli)

ÇITAKU Yll (1979-). Regjisor filmi. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për regji filmi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Është autor i disa dokumentarëve, si: “Të rri apo të shkoj” (2001), me të cilin në Festivalin Dokufest (Prizren) fitoi çmimin për filmin më të mirë dokumentar, ndërkohë që në po këtë festival u nderua me çmimin e dytë për dokumentarin “Ndoshta vetëm një keqkuptim” (2001). Është regjisor i filmit të metrazhit të mesëm “Tatita” (2006), me të cilin në Festivalin Ndërkombëtar Studentor të Filmit “Filofest” (Slloveni) u nderua me çmimin për regjinë më të mirë, si dhe i filmave të metrazhit të gjatë “Shkaba” (2006) dhe “Përtej rrugës” (2009), me të cilin në Festivalin e 13-të të Filmit Shqiptar në Tiranë fitoi çmimin special të jurisë. Si bashkautor realizoi edhe filmin e metrazhit të shkurtër “Si qeni n’rrush” (2010), me të cilin fitoi çmimin special në Festivalin Dokufest në Prizren. Është laureat i Çmimit “Rudolf Sopi” (2003), të cilin për kamerën më të mirë në zhanrin artistik e ndan Radiotelevizioni i Kosovës. Është themelues dhe drejtues i produksionit të pavarur filmik “Koperativa”. (Doruntina Basha)

ÇLIRIMI I QYTETEVE MË 1912 (korrik 1912). Largimi i administrimit dhe i pushtetit osman në disa qytete të vilajetit të Kosovës dhe vendosja e administratës me drejtues shqiptarë, në korrik të vitit 1912, pas fitores së forcave kryengritëse shqiptare. Qyteti i parë që u çlirua ishte Gjakova. Forcat kryengritëse, të udhëhequra nga Bajram Curri, pas goditjes së rëndë që ua dhanë njësisve osmane në Has dhe në Qafë të Prushit, rrethuan Gjakovën dhe më 16 korrik hynë në qytet pa luftë. Pas disa ditësh, rreth 10,000-12,000 kryengritës, të grumbulluar në Gjakovë, ia mësynë Prizrenit, të cilin e çliruan pa luftë. Pas rrethimit të zyrës së telegrafit nga qytetarët e Prishtinës, gjë që e shtrëngoi komandantin osman të hiqte dorë nga qëndresa, mijëra kryengritës nga të gjitha viset e vilajetit të Kosovës hynë në Prishtinë më 21 korrik dhe e çliruan atë. Të nesërmen, forcat kryengritëse të Mitrovicës dhe viseve përreth, çliruan qytetin e Pazarit të Ri. Më 23 korrik edhe qyteti i Tetovës ishte në duar të kryengritësve të komanduar nga Mehmet Pashë Deralla. Forcat kryengritëse të Gjilanit dhe të viseve përreth më 25 korrik 1912

depërtuan në fshatin Tërrnoc të Bujanocit dhe bënë që të nesërmen qyteti i Bujanocit të çlirohej nga pushteti dhe administrata osmane. Në anën tjetër, forcat kryengritëse të drejtuara nga Isa Boletini, rreth 6,000 veta, nga Pazari i Ri u drejtuan për në Mitrovicë. Ky qytet, pas bisedimeve ndërmjet nënprefektit dhe Isa Boletinit, u dorëzua pa luftë më 27 korrik. Pas Mitrovicës u çliruan edhe Vushtrria e Ferizaj. Edhe popullsia e Pejës, e udhëhequr nga krerë të zejtarëve dhe të tregtarëve të vegjël, në mbledhjen e datës 27 korrik vendosi të bashkohej me kryengritjen. Pas vendimeve që morën në kuvendin e Pozheranit, mbi 4,000 kryengritës, nën komandën e Idriz Seferit, Bejtullah Beut, Sali Agës dhe të Ahmet Agës, më 28 korrik u çliruan Gjilanin. Kështu, rreth 30,000 kryengritës, me gjithë mungesën e ushqimeve, të veshmbathjeve e sidomos të materialeve luftarake, po marshonin në të gjitha anët e Kosovës, edhe pse kishin përballë rreth 70,000 ushtarë osmanë, të armatosur mirë dhe të përforcuar me reparte artilerie e kalorësie. Kryengritësit kudo ku hynë u pritën me entuziazëm nga popullsia vendase. Me të hyrë në qytete ata lironin të burgosurit dhe dëbonin funksionarët osmanë. Pas sukseseve që arritën forcat kryengritëse kundër ushtrisë osmane dhe pas çlirimit të një pjese të mirë të qyteteve, në vilajetin e Kosovës për një kohë u ndërpre në veprimet luftarake. Repartet ushtarake osmane u tërhoqën kudo në kazerma. Organet administrative xhonturke po ua lëshonin vendin udhëheqësve të kryengritjes, të cilët formuan këshillat lokale. Këto këshilla në shumë vende morën rolin e organeve të pushtetit të ri shqiptar, që kishte dalë nga kryengritja e armatosur. (Fitim Rifati)

ÇMIMI "MUSLIM MULLIQI". Çmimi më i lartë për artet pamore në Kosovë, i themeluar në vitin 2003 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës. Çmimi ndahet me rastin e hapjes së ekspozitës ndërkombëtare, e cila është bërë tradicionale dhe organizohet në muajin dhjetor në Galerinë e Arteve të Kosovës. Në ekspozitën e parë të organizuar në dhjetor të vitit 2003, kanë ekspozuar 50 autorë, vendorë dhe ndërkombëtarë. Manifestimi ka vazhduar traditën pa ndërprerje, në të njëjtin muaj, deri sot. Në çdo ekspozitë përzgjidhet krijuesi më i mirë i këtij evenimenti ndërkombëtar. (Hivzi Muharremi)

ÇMIMI "REXHO MULLIQI". U themelua në vitin 1982, si çmim i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës dhe më vonë u pagëzua më emrin e kompozitorit Rexho Mulliqi. Jepej për veprat më të realizuara brenda vitit në fusha të ndryshme të krijimtarisë muzikore nga anëtarët e Shoqatës. Qëllimi kryesor ishte nxitja e krijimtarisë origjinale muzikore. Me çmimin e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës "Rexho Mulliqi", nga viti 1982 deri në vitin 1991 u nderuan disa anëtarë të Shoqatës, kryesisht për vepra origjinale të kompozuar dhe më pas të ekzekutuara në manifestimet muzikore brenda dhe jashtë Kosovës ("Skena Muzikore e Prishtinës", "Ditët e Muzikës Kosovare" etj.). Pas vitit 1999, megjithë përpjekjet e bëra, nuk u arrit që ky çmim të rikthehet në traditën e mëhershme. (Zeqirja Ballata)

ÇMIMI "STUDENT I DALLUAR". Çmim i Universitetit të Prishtinës, dedikuar studentëve të tij më rezultate më të mira në studime, i themeluar në vitet '80 të shek. XX. U ndahet studentëve të vitit të fundit të studimeve me notën mesatare 10 dhe, në mungesë të studentëve të tillë, u ndahet edhe studentëve me notë mesatare jo më pak se 9, të cilët nuk kanë përsëritur asnjë vit të studimeve. Ky çmim i përvitshëm u jepet më së shumti 4 studentëve për çdo njësi akademike (fakultet) të Universitetit të Prishtinës. Lartësinë financiare të tij e përcakton Këshilli Drejtues i këtij institucioni. Ndahet çdo vit me rastin e ditës së Universitetit. (Selim Mehmeti)

ÇMIMI LETRAR "AZEM SHKRELI". Çmim i themeluar në vitin 2004, me vendim të Ministrisë së Kulturës, të Rinisë, të Sportit dhe Çështjeve Jorezidente. Shkrimtari i parë që fitoi Çmimin Kombëtar "Azem Shkreli" për vepër jetësore në letërsi ishte poeti Din Mehmeti (1929-2010), ndërsa fituesi i parë i Çmimit për veprën më të mirë të vitit (2004) është shkrimtari Mehmet Kraja (1952) për romanin "Edhe të çmendurit fluturojnë". Në vitin 2009 u hartua një rregullore e veçantë për këtë çmim. Tani emërtimi i plotë i këtij çmimi letrar është: Çmimi Kombëtar Letrar "Azem Shkreli" dhe çmimet vjetore për librin më të mirë të vitit paraprak. Në mars të vitit 2010 u ndanë katër çmime: për librin më të mirë në prozë, për librin më të mirë në poezi, për librin më të mirë në kritikë letrare e eseistike dhe për librin

më të mirë të përkthyer. Në vitin 2015 u shtua edhe çmimi për librin më të mirë për fëmijë. U themelua për të nderuar emrin e shkrimtarit Azem Shkreli (1938-1997) dhe për të motivuar e nderuar krijimtarinë letrare origjinale shqipe. (Ragip Sylaj)

ÇMIMI LETRAR “BEQIR MUSLIU”. Çmim letrar i themeluar në vitin 2004, me inicimin e klubit të shkrimtarëve “Beqir Musliu” në Gjilan. Çmimi Letrar “Beqir Musliu”, të cilin e ndan kryetari i komunës së Gjilanit, u jepet shkrimtarëve që kanë shënuar arritje të rëndësishme në fushën e letërsisë në të tri gjinitë (poezi, prozë, dramë). Fitues i parë i këtij çmimi ishte poeti Ali Podrimja. Një kohë ky çmim jepej në çdo tri vjet, por kohëve të fundit jepet për çdo vit. (Ragip Sylaj)

ÇMIMI LETRAR “ESAD MEKULI” (“H. SULEJMANI”). Çmim letrar i themeluar njëkohësisht me manifestimin letrar “Hivzi Sulejmani”, më 12 korrik të vitit 1983, datë që përkonte me ditëlindjen e poetit, prozatorit e dramaturgut Hivzi Sulejmani (1910-1975). Ishte nismë e administratës komunale të kulturës së Prishtinës, e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe të redaksisë së botimeve “Rilindja”. Çmimi jepej për çdo vit nga themeluesi për veprën më të mirë në prozë të botuar ndërmjet dy takimeve letrare. Fitues të këtij çmimi ishin anëtarët e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Laureati i parë i këtij çmimi ishte Esad Mekuli. Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, e transformuar pas luftës së Kosovës në asociacionin letrar me emërtimin Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, në vitin 2010 e riemërtoi manifestimin letrar me emrin e poetit dhe veprimtarit të shquar të kulturës në Kosovë, Esad Mekulit (1916-1993). Po ashtu edhe emri i çmimit letrar “Hivzi Sulejmani” u riemërtua në “Esad Mekuli” dhe jepet çdo vit më 17 dhjetor, në ditëlindjen e poetit të njohur. Fitues i parë i çmimit tradicional letrar “Esad Mekuli” për krijimtari letrare ishte shkrimtari Rexhep Hoxha (1999). (Ragip Sylaj)

ÇMIMI LETRAR “PJETËR BOGDANI”. Çmim vjetor i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për veprën më të mirë letrare (në të gjitha gjinitë) për anëtarët e saj. Për këtë çmim letrar juria profesionale e Shoqatës

shqyrtonte dhe vlerësonte produksionin letrar vjetor. Në vitet '90 çmimi mori emrin e shkrimtarit të letërsisë së vjetër shqipe, Pjetër Bogdanit (1625- 1689). Këtë çmim për disa vjet vazhdoi ta japë edhe trashëgimtari i këtij asociacioni të shkrimtarëve, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës. Fitues të këtij çmimi letrar janë shumë shkrimtarë të njohur. Deri në themelimin e çmimit “Azem Shkreli” nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve e Kosovës, çmimi letrar “Pjetër Bogdani” ishte çmimi kryesor për letërsi. (Ragip Sylaj)

ÇMIMI LETRAR “REXHAI SURROI”. Çmim i kompanisë mediale “Koha” në Prishtinë, i cili jepet nga viti 2008 për romanin më të mirë shqiptar të botuar brenda vitit. Fituesit i parë i këtij çmimi ishte shkrimtari Kim Mehmeti (1955) për romanin “Vitet e urithit”. Këtë çmim Grupi “Koha” e jep në datën 22 dhjetor, në nderim të jetës e veprës letrare të shkrimtarit dhe diplomatit, Rexhai Surroi (1929-1988). Krahas çmimit për letërsi (roman) me emrin e këtij shkrimtari jepet edhe çmimi për gazetari. (Ragip Sylaj)

ÇMIMI. Është shuma e parave të paguara për njësi të mallit ose të shërbimit. Në disa tregje blerësit dhe shitësit bëjnë pazar për çmimin dhe sasinë e secilit produkt ose shërbim. Çmimi i produkteve të ngjashme në kohë dhe vende të ndryshme mund të ndryshojë, ashtu sikundër që mallrat me emër të njëjtë ndryshojnë cilësi. Indeksi i çmimeve shpreh ndryshimet dhe lëvizjet çmimeve në periudha të caktuara kohore. Në analizën ekonomike çmimet mund të jenë vijuese dhe të pandryshuara (konstante), të cilat përdoren për rivlerësim të vëllimeve, të këmbimeve dhe të aktivitetit ekonomik. Në Kosovën e pasluftës së fundit, indeksi i çmimeve të konsumit ka filluar të llogaritet prej qershorit të vitit 2002 me bazë muajin maj të atij viti, për periudhën 2003-2014. Në vitet 2004, 2005 dhe 2009 indeksi i çmimeve të konsumit ka shënuar rënie, ndërsa në të gjitha vitet e tjera ka shënuar rritje në nivele njëshifrore. Indeksi i çmimeve të prodhimit ka filluar të llogaritet prej vitit 2009 dhe ka shënuar rritje të vazhdueshme, ndërsa indeksi i çmimeve të importit ka filluar të llogaritet prej vitit 2006 dhe ka shënuar rritje të përvitshme, me përjashtim të vitit 2009, kur ka shënuar rënie prej 4.8% dhe në vitin 2014 po

ashtu ka shënuar rënie prej 0.4% në raport me vitin paraprak. (Ramiz Livoreka)

ÇOLLAKOVIQ Bozhidar (Božidar Čolaković) (1931-). Mjek, internist, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1956). Specializoi për mjekësi interne, kardiologji dhe mjekësi sociale. Pas diplomimit një kohë punoi si mjek internist dhe kardiolog në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, ku ishte edhe drejtor. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, kaloi në katedrën e mjekësisë preventive. Mbrojti tezën e doktoratës në Universitetin e Beogradit (1975). Ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë (1983-1985) dhe rektor i Universitetit të Prishtinës (1986-1988). Botoi tekste universitare, studime monografike: “Epidemiologjia, higjiena dhe mjekësia sociale” (1991), “Sëmundja koronare e zemrës dhe diabet mellitus” (1977), “Kardiologjia preventive” (1981), “Epidemiologjia e përgjithshme dhe speciale” (1988) etj. Është autor i shumë punimeve profesionale dhe shkencore. (Ilir Begolli)

ÇOÇA Mitalip (1936-1997). Gazetar, xhirues. Lindi në Prizren. Pasi kreu Shkollën Normale në Prizren, punoi mësues në Suharekë dhe më pas si korrespondent i Radio Prishtinës dhe i disa gazetave dhe revistave nga Prizreni. Më 1964 vijon mësimet për gazetari në Beograd dhe më pas punoi xhirues dhe reporter nga Kosova për Radiotelevizionin e Beogradit. Ishte xhiruesi i parë televiziv shqiptar nga Kosova. Më 1966 bëhet reporter-xhirues i programit në gjuhën shqipe të Televizionit të Beogradit. Pas vitit 1974 punoi në Televizionin e Prishtinës dhe më vonë në përfaqësitë diplomatike të ish-Jugosllavisë në Këln dhe Shtutgart. (Nehat Islami)

ÇUBRILLOVIQ (Čubrilović) Vaso (1897-1990). Historian serb, profesor universiteti, akademik. Lindi në Bosanska Gradishka, në Bosnjë. Si student dhe anëtar i organizatës “Bosnja e Re”, mori pjesë në vrasjen e Arkidukës Ferdinand të Austro-Hungarisë në Sarajevo më 1914. Në periudhën midis dy luftërave botërore ishte profesor në Fakultetin Filozofik

në Beograd. Mbrojti disertacionin e doktoratës në vitin 1929. U bë i njohur si eksponent nacionalist i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, në emër të së cilës përgatiti dhe paraqiti një sërë elaboratesh me ndikim të madh politik, ndër të cilët edhe elaboratet lidhur me spastrimin etnik të shqiptarëve: “Shpërngulja e shqiptarëve”, i paraqitur në Beograd më 1937 dhe “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e Re”, i paraqitur po në Beograd më 3 nëntor 1944. Çubrilloviqi shërbeu në poste ministrore pas Luftës së Dytë Botërore. Shkroi edhe një sërë monografish historike. (Kosovar Basha)

ÇUKA. Toponim i vendbanimeve kodrinore parahistorike, antike dhe mesjetare. Toponimi është i përhapur gati në të gjitha trevat shqiptare dhe njihet dhe me variantin “suka”. Vendbanimet më të njohura të tilla në Kosovë janë: Çuka e Brainës dhe Çuka e Drazhnjës jo larg Podujevës, si dhe Suka e Cërmjanit afër Gjakovës. (Haxhi Mehmetaj)

ÇUNI Anton (1967-). Ushtarak, pjesëmarrës i luftës për çlirimin e Kosovës. Lindi në Fshaj të Gjakovës. Kreu Gjimnazin Ushtarak në Beograd dhe më pas Akademinë Ushtarake në Beograd dhe në Sarajevë. Në



ANTON ÇUNI

Në vitin 1991 u largua nga ushtria dhe emigroi në Zvicër dhe Gjermani. Në vitin 1998 u emërua komandant i Batalionit Diversant-Vëzhgues, i cili vepronte nën urdhërat e ministrit të Mbrojtjes të Qeverisë së Republikës së Kosovës në emigrim. Në vitin 1999 u emërua shef i operativës në Grupin Operativ 3 dhe njëherësh ishte bashkëhartues i planit operacional për hapjen e korridorit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, që rezultoi me betejën e njohur të Kosharës. Në vitin 1999 u emërua shef i shtabit të Brigadës 138 “Agim Ramadani”. Pas përfundimit të luftës, nga viti 1999 deri në vitin 2010 mori detyrën e përgjegjës të lartë për edukimin dhe trajnimin e kuadrove të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Që nga zgjedhjet e vitit 2011 është deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. (Besim Myrtezani)

D

DA DEZIO Didacus (Da Desio) (shek. XVIII). Mësuesi i parë i gjuhës shqipe në Romë në Kolegjin e Shën Pietro Montorios nga 20 prill 1711 deri më 1722. Misionar në Mat (Macedonia) nga 1702-1710. Në dokumentacionin e propaganda Fides cilësohej si “besimtar dhe praktikues i gjuhës shqipe, e ka gati për shtyp një gramatikë të kësaj gjuhe”. Mund të jetë autori i Gramatikës së vogël shqipe të vitit 1710, që ruhet bashkë me fjalorin në Dorëshkrimin e Manastirit Grotaferrata. Dorëshkrimi i Grotaferratës me faksimilet dhe transkriptimin, interpretimet e historinë tjetër të librit dhe diskutimin për autorin e mundshëm të tij është botuar te “Rilindja”, Prishtinë më 1982 nga R. Ismajli. (Bardh Rugova).

DA LEÇE Françesko (Francesco Maria Da Lecce) (?-1718). Gjuhëtar italian, albanolog, misionar katolik. Lindi në Itali në vitet pesëdhjetë të shekullit XVII. Misionar katolik i dërguar në Shqipëri nga Kongregacioni i Shenjtë i Propagandës Fide më 1692, si “prefekt apostolik i misioneve në Maqedoni”. Njihet për gramatikën më të hershme të botuar të shqipes, me titull “Vërejtje gramatikore mbi gjuhën shqipe dhe drejtshkrimin e saj” (Osservazioni grammaticali nella lingua albanese), botuar në Romë më 1716, si dhe për fjalorin italisht-shqip ”Dittionario italiano-albanese”, që mendohej i humbur. U zbulua nga M. Mandalà më 1995 (botimi kritik 2009, Shkodër nga G. Gurga). Besohet të jetë hartuar rreth vitit 1702. Gramatika e tij ka rëndësi historike për gjuhën e kulturën shqiptare. Ajo ndahet në dy pjesë: në morfologji dhe ortografi. (Mensur Vokri)

DABAJ Gjokë (1938-). Mësimdhënës, publicist dhe shkrimtar. Lindi në Stamboll, në emigrim. Në moshë të njomë kthehet në vendlindjen e

prindërve, në Dedaj të Shestanit. Shkollimin fillor e bëri në Salç (Ulqin) dhe në vendlindje, ndërsa gjimnazin e ulët e kreu në Ulqin dhe në Tivar. Në vitin 1957 u regjistrua për mësuesi në Normalen e Nikshiqit dhe vazhdoi në Normalen e Gjakovës dhe të Prizrenit. Ishte njëri nga themeluesit e organizatës patriotike “Liria”. Për arsye politike, në vitin 1962 arratiset në Shqipëri. Pas shumë peripecive, studioi për gjuhë dhe letërsi në Universitetin e Tiranës. Me përfundimin e studimeve punoi si mësimdhënës në disa rrethe të vendit, kryesisht në fshatra të Matit. Merret me publicistikë dhe është autor i disa veprave historike, studimore dhe letrare, ndër të cilat: “Shestani, studim filologjik gjithpërfshirës” (2004), “Fjalor i Selman Rizës” (2007), “Prush plagësh të pambyllura, poemë për masakrën e Tivarit” (2007) “Strategjia e shqiptarëve” (2011), “Në rrugë rreziqesh me vetëdije” (2013), “E kaluara e vërtetë e Arqipeshkvisë së Tivarit” (2014) etj. (Hajrullah Koliqi)

DABISHECI. Fshat në komunën e Prishtinës. Është vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë. Dabisheci është vendbanim i vjetër, që dëshmohet nga toponimet dhe gjetjet arkeologjike. Në periferi të fshatit kalon rruga automobilistike rajonale Prishtinë-Medvegjë-Leskocv. Në dokumentet e shkruara për herë të parë përmendet në librin e tregtarit novobërdas, Mikel Llukarit (1438) me emrin Dabixivozi. Pas viteve 1877-78 këtu vendosen familjet e muhaxhirëve nga sanxhaku i Nishit, ndërsa pas pushtimit serb (1913) një numër i banorëve shpërngulen për në Turqi. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në Dabishec u vendosën si kolonë 17 familje malazeze. Sipas regjistrimit të vitit 1913, Dabisheci kishte 321 banorë, në vitin 1948, kishte 577 banorë,

ndërsa në vitin 1999 fshati kishe 63 shtëpi me rreth 600 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror, Dabisheci ka shkollën e mesme të ulët nëntëvjeçare me paralelet e ndara në Hajkobillë dhe Glogovicë, zyrën e vendit, stacionin shëndetësor etj. (Nazif Gashi)

DABISHEVCI Donika (1980-). Poete, gazetare dhe studiuese e letërsisë. Lindi në Prishtinë, ku përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet themelore dhe pasuniversitare për letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. U doktorua në Universitetin e Tiranës, në departamentin e letërsisë të Fakultetit Histori-Filologji (2013). Nga viti 2012 është redaktore në Radiotelevizionin e Kosovës. Ka botuar dy libra me poezi: “Krizantema të plasura” (1996) dhe “Imazhe të brishta” (2004). Ka botuar librin studimor “Proza e poetizuar - F. Konica, M. Frashëri, E. Koliqi, M. Camaj, M. Hanxhari” (2015), që njëkohësisht ishte edhe punimi i saj i doktoratës. Me punimet e saj ka marrë pjesë në seminare e konferenca të fushës së albanologjisë dhe gazetarisë. (Agron Gashi)


DACI Hamdi (1942-). Anglicist, studiues i letërsisë, profesor. Ka lindur në Tërnovc të Bujanovcit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Shkup. Është diplomuar në Universitetin e Shkupit për gjuhë dhe letërsi angleze dhe ka studiuar edhe në Universitetin North Wallis në Bungor të Britanisë. Ka doktoruar më 1980 në Universitetin e Prishtinës me temën “Kritika letrare marksiste angleze në shekullin XX”. Ka punuar mësues dhe arsimtar i anglishtes në Tërnovc, ndërsa në Universitetin e Prishtinës ka punuar prej vitit 1974, duke marrë të gjitha gradat universitare. Ka publikuar në revista në Kosovë dhe jashtë disa studime që lidhen me poezinë e Eliotit, të Yetsit, por edhe përgjithësisht për krijimtarinë letrare angleze të viteve '30. Ka mbajtur mësim edhe në Universitetin e Tetovës. (Lindita Sejdiu-Rugova)

DACI Hysen (1934-). Veprimtar i lëvizjes për çlirim kombëtar, ish-i burgosur politik. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe Gjimnazin e Ulët e kreu në vendlindje. Nga viti 1948 ushtroi profesionin e orëtarit, një herë në Pejë dhe pasaj në Mitrovicë. Në shtëpinë e tij në Mitrovicë, një grup të rinjsh, në krye me

Adem Demaçin, më 28 nëntor 1963 themeluan organizatën ilegale Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Organizata kishte synim realizimin e të drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe të viseve të tjera të banuara me shumicë shqiptare në Jugosllavi. H. Daci u emërua kryetar i komitetit të Mitrovicës të kësaj organizate dhe për disa muaj vepron ilegalisht. Më 8 qershor të vitit 1964 organet e ndjekjes e zbulojnë veprimtarinë e organizatës dhe me këtë rast H. Daci u dënua me 7 vjet burgim të rëndë. Në vitin 1968 u lirua nga burgju, por ishte gjithnjë nën vëzhgimin e organeve policore. Një kohë qëndroi në Danimarkë, më pas u kthye në Prishtinë dhe për disa vjet sërish vazhdoi profesionin e orëtarit. (Sulltane Ukaj)

DACI Myderriz Jahja (1905-1944). Titullar i fesë islame. Lindi në Pejë. Mësimet e para fetare dhe medresenë i kreu në Pejë, ndërsa studimet universitare i vazhdoi në Kajro, në Universitetin “El-Ez’herit”. Pas kthimit në vendlindje, punoi si imam në Rahovec, më pas në Istog. Gjatë shërbimit si imam në Istog ngriti zërin kundër pushtetit serb. Me shkresa të ndryshme, përmes Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, njoftonte opinionin ndërkombëtar për gjendjen e rëndë të popullsisë shqiptare në Kosovë. Ngriti zërin kundër shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Bashkëpunoi me organizatën “Bashkimi” (Xhemijeti), ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore, së bashku me mulla Zekë Bërdynajn nga Radavci dhe shumë të tjerë, organizuan vullnetarët për të mbrojtur popullsinë e trevave të Pazarit të Ri dhe të Tutinit nga sulmet çetnike. Ishte anëtar dhe veprimtar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Në vitin 1944 u arrestua në Drenicë nga forcat partizane dhe u pushkatua. (Nuridin Ahmeti)

DACI Nexhat (1944-). Kimist, profesor universiteti, akademik. Lindi në Tërroc të Bujanocit. Shkollimin e kreu në vendlindje dhe Leskovc (1960). Studimet e rregullta për kimi i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit (1966), ku mbaron edhe studimet pasuniversitare (1968). Një kurs pasuniversitar e kreu në Liezh, Belgjikë (1970). Tezën e disertacionit të



NEXHAT DACI

doktoratës e mbrojt në Universitetin e Zagrebit (1973). Studimet e pasdoktoratës i vazhdoi në Angli, në Universitetin e Bradfordit (1974). Në vitin 1966 u zgjodh asistent në degën e kimisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, pastaj ligjërues, profesor inordinar dhe në vitin 1984 merr titullin profesor ordinar. Ka bërë shumë udhëtime studimore në vende të ndryshme të botës. Është anëtar i disa institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtare, ndër të cilat edhe i Shoqatës Kimistëve Amerikanë (1985), i Akademisë Europiane për Çështje të Mjedisit në Tübingen, në Gjermani dhe Londër (1987). Në vitin 1994 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 1996 anëtar i rregullt, dhe më pas bëhet sekretar i përgjithshëm dhe kryetar i saj (1999-2002). Në vitin 2014 u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve (ALLEA) me seli në Salzburg. Anëtar i përhershëm i komitetit të ALLEAS për projekte shkencore u zgjodh në vitin 2015. N. Daci ka qenë aktiv në jetën politike dhe institucionale të Kosovës: në periudhën 2001-2011 u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës dhe në vitet 2001-2006 ishte kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në vitin 2007 themeloi Lidhjen Demokratike të Dardanisë dhe u bë kryetar i saj. Veprimtaria e tij shkencore përmban punime shkencore të publikuara në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, projekte shkencore, elaborate, kumtesa, tekste universitare etj. Veçohen punimet shkencore mbi strukturën e substancës organike të qymyrit të Kosovës, pastaj të përbërësve inorganikë të qymyrit, të analizave të ndryshme të hirit nga termocentralet dhe punime shkencore nga fusha e mbrojtjes së mjedisit, veçmas të ujërave të liqeneve akumuluese dhe të disa lumenjve të Kosovës. Ishte bartës ose pjesëmarrës në shumë projekte shkencore nga fusha e mbrojtjes së mjedisit. Udhëhoqi projektin shkencor të ASHAK-ut “Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre” (2012-2014) dhe projektin për kadastrin e këtyre ndotësve e trajtimin e tyre. Është autor i teksteve universitare dhe monografive (“Kimia organike”, “Struktura e substancave organike të qymyrit të Kosovës”), si dhe bashkautor i një studimi në botimin “Kimia për mbrojtjen e mjedisit” (Elsevier, Amsterdam, Nju-Jork, Oksford, 1987). Është bashkautor i studimit monografik

“Shkenca e mjedisit - zhvillim i qëndrueshëm” dhe autor dhe bashkautor i teksteve shkollore dhe universitare. Është bartës i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve për veprimtari arsimore dhe shkencore. (Fejzullah Krasniqi)

DACI Ramadan (1936-). Mësimdhënës, veprimtar. Lindi në Tërnoc të Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në Tërnoc, gjimnazin e ulët në Prishtinë, Preshevë dhe Bujanoc. Kreu edhe shkollën normale të Gjilanit. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup. Pa shkëputje nga puna kreu edhe studimet universitare për gjuhë e letërsi. Si mësues filloi të punojë në fshatin Lluçan, pastaj mësimdhënës dhe drejtor i shkollës fillore në Tërnoc. Kontribuoi për hapjen e paraleleve të gjimnazit të Preshevës në Tërnoc. Ishte edhe mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në gjimnaz, i cili nga Tërnoci u transferua në Bujanoc. Për shkak të aktivitetit të tij politik, autoritetet serbe e përjashtuan nga puna. Në vitin 1997 zgjidhet deputet në Parlamentin e Serbisë. U shqua si luftëtar për të drejtat e shqiptarëve në Serbi. (Gafur Hyseni)

DAJKOCI Rexhep (1909-1979). Pjesëtar i Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, i dënuar politik. Lindi në Dajkoc të Kamenicës. Më 1927 shpërngulet në Shqipëri, kurse më 1941 kthehet sërish dhe vendoset në Gjilan. Kah fundi i vitit 1944 mobilizohet në radhët e Brigatës VII të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës. Në brigadë qëndroi deri në shtator të vitit 1945. Më 1946 përfshihet në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). U zgjodh kryetar i komitetit të rrethit të LNDSH-së për Gjilan. Më 25 korrik të vitit 1946 merr pjesë në Kongresin e Lipovicës (Blinajës). Nuk u zbulua për pjesëmarrjen në Kongres, por u arrestua pas zbulimit të Komitetit Qendror të LNDSH-së, u arrestua në tetor të vitit 1946 dhe u mbajt në burgun e Ferizajt, pastaj të Gjilanit. Në shkurt të vitit 1947 Gjykata e Qarkut në Gjilan e dënoi me 15 vjet burg. Burgun e mbajti në Mitrovicë të Stremit. Edhe pas lirimimit nga burgu u angazhua për çështjen kombëtare. (Naim Musliu)

DAKA Hysni (1952-). Mjek, fiziolog, imunolog, profesor universiteti. Lindi në Kabash të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prizren. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1978. Nga viti 1979



HYSNI DAKA

punoi në Institutin e Fiziologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare për imunologji klinike me alergologji i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ku mbrojti edhe magjistraturën (1985). Më 1987 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë e mbrojti disertacionin e doktoratës po nga kjo fushë. Emërohet asistent më 1979 dhe në vitet vijuese merr të gjithë titujt përkatës universitarë. Më 2001 u zgjodh profesor ordinar i lëndës së fiziologjisë së njeriut dhe i imunologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Kreu detyra të ndryshme në institucionet e shkollimit të lartë, kryetar i Shoqatës së Alergologëve dhe Imunologëve të Kosovës, anëtar i Akademisë Europiane të Alergologëve dhe Imunologëve, profesor i fiziologjisë së sportit në Fakultetin e Shkencave Sportive, profesor i fiziologjisë dhe i imunologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tetovës etj. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe autor i tekstit universitar “Bazat e imunologjisë” (2013). Përktheu dhe adaptoi tekste universitare nga fusha e fiziologjisë dhe imunologjisë. (Halil Ahmetaj)

DAKA Luan (1951-). Regjisor, aktor. Lindi në Prishtinë. Kreu gjimnazin në Prizren, ndërsa studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Mbaroi studimet për



LUAN DAKA

regji filmi dhe televizioni në Akademinë e Filmit në Moskë më 1978. Pas studimeve punoi si regjisor në Televizionin e Prishtinës, ku realizoi filma televizivë, drama, dokumentarë dhe emisione për fëmijë. Bëri regjinë e një sërë shfaqjesh teatrale në teatrot e Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës, disa nga të cilat janë: “Dinosauri” (J. Buxhovi), “Anija e peshkatarit” (S. Pitarka), “Borgjezi fisnik” (Molier), “Nëna Kurajë” (B. Brehti), “Anija e vjetër” (R. Shabani). “Tezja e Karlit” (K. Floqi), “Burri burrë” (K. Floqi), “Pas vdekjes” (F. Paçrami), “Mosmarrëveshja” (A. Kamy) etj. Luajti në disa shfaqje në teatër, në

projekte filmike dhe televizive. Që nga viti 1990 ishte mësimdhënës i aktrimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Selman Jusufi)

DAKA Sylejman (1945-). Inxhinier i ndërtimit, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kabash, komuna e Prizrenit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Prizren, ndërsa studimet në Universitetin e Shkupit. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit (1986), ndërsa disertacionin e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (UP) (1994). Pas përfundimit të studimeve punësohet në ndërmarrjen e ujësjellësit në Prizren, e më pas në ndërmarrjen “Hidroekonomia” në Prishtinë. Në vitin 1988 u zgjodh ligjërues në Fakultetin Teknik të UP-së, ndërsa në vitet vijuese punon në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës, ku më 2006 merr titullin profesor i rregullt. Është autor i teksteve universitare “Sistemet hidroteknike” (2002), “Furnizimi me ujë” (2008) etj. dhe i disa dispensave në fushën e hidroteknikës. Është pjesëmarrës në konferenca dhe në disa simpoziume brenda dhe jashtë vendit. Zhvilloi aktivitete në fushën e hidroteknikës në bashkëpunim me disa universitete të Europës dhe është pjesëmarrës e udhëheqës i shumë projekteve në fushën e ujësjellësit dhe të kanalizimit për vendbanime në Kosovë. (Naser Kabashi)



SYLEJMAN DAKA

DAKISHTJA. Gjuhë indoeuropiane paleo-ballkanike. Dakishtja flitej në veri të Danubit, në hapësirat e rumanishtes së sotme. Disa studiues e shohin si dialekt të trakishtes, ndërsa ka të tjerë që e konsiderojnë gjuhë indoeuropiane të veçantë, të ndryshme, por të afërt me trakishten. Njihet nga emra njerëzish, fisesh, perëndish, vendesh, një numri të kufizuar glosash dhe të një mbishkrimi të vetëm: *Decebalus per Scorilo*, që ndonjëherë është krahasuar me formulën shqipe të tipit Gegë Pergega. Të tjerë mendojnë se aty kemi të bëjmë thjesht me një formulë latine. Mendohet të ketë qenë gjuhë satem. Në gjuhësinë ballkanike është e njohur hipoteza e substratit dak (trak) të rumanishtes. V. Georgiev e disa

gjuhëtarë rumunë mendojnë se gjuha shqipe e ka prejardhjen nga dakishtja, përkatësisht dako-mezishtja. (Ardita Berisha)

DAKLANI Bajram (?-1923). Veprimtar dhe luftëtar për çlirimin e Kosovës. Lindi në Gjakovë. Luftoi kundër politikës nacionaliste antishqiptare të Turqve të Rinj, të cilët më 1909 e dënuan me vdekje, në mungesë. Me çetën e tij mori pjesë në kryengritjen kundërosmane të vitit 1910, organizoi vrasjen e të dërguarit të sulltanit, Ethem Pashës, më 1911 afër fshatit Hereç (Gjakovë). Është bashkautor i thirrjes së lëshuar nga “Krerët e Kryengritjes së Kosovës” në maj të vitit 1912 drejtuar popullit shqiptar për bashkimin e shoqërive atdhetare në luftë për autonominë e Shqipërisë. Mori pjesë në Kuvendin e Junikut më 21-25 maj të vitit 1912 dhe në luftën për realizimin e vendimeve të tij, gjatë kryengritjes së përgjithshme shqiptare të vitit 1912. I priu parisë së Gjakovës në çlirimin e shumë qyteteve të Kosovës dhe më 12 gusht 1912 ishte njëri prej të parëve, me afro 200 vetë, që hyn në qytetin e Shkupit, ku shpalosi flamurin kombëtar shqiptar. Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë mbështeti Qeverinë e Vlorës dhe mori pjesë në kryengritjen antiserbe të shtatorit 1913 për bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar. Më 1918 u lidh me Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe luftoi kundër politikës pushtuese të Serbisë ndaj tokave shqiptare. Vdiq në rrethana të pandriçuara. (Alban Dobruna)

DALIPI Qerim (1970-). Historian medievalist, profesor universiteti. Lindi në Zajaz të Kërçovës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollimin e mesëm në Kërçovë e Shkup. Ndoqi studimet për histori në Universitetin e Prishtinës, ku kreu edhe studimet pasuniversitare (2000). Më pas vijoi studimet e doktoratës në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup (2009). Një kohë punoi si mësimdhënës i historisë në gjimnazin e Kërçovës, më pas asistent dhe mësimdhënës në katedrën e historisë të Universitetit të Tetovës. Është autor i disa monografive shkencore: “Inkursionet osmane në trevat shqiptare deri më 1402 (2012), “Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane 1355-1443” (2002) dhe i një sërë studimesh shkencore e profesionale nga historia mesjetare dhe e periudhës osmane të botuara në revista relevante shkencore në Kosovë dhe Maqedoni. (Jahja Drançolli)

DALMATISHTJA. Gjuhë indoeuropiane, neolatine perëndimore. Dalmatishtja është gjuhë e zhdukur. Gjatë Mesjetës flitej në Dalmaci, në bregun lindor të detit Adriatik dhe në ishujt e Kroacisë së sotme. Dokumentet më të vjetra të shkruara nga dalmatishtja janë inventarët e Raguzës që i takojnë shekullit XIII. Dalmatishtja, konkretisht dialekti raguzan, u bë e njohur me anë të dy letrave, të cilat u përkasin viteve 1325 dhe 1397 dhe paraqisnin një gjuhë shumë të ndikuar nga venetishtja, gjuhë/dialekt roman. Burimet e vlefshme përfshijnë rreth 260 fjalë dalmate. Dalmatishtja u zhduk në fund të shekullit XIX. Gjuha e folësit të fundit është studiuar nga Mateo Bartoli. Mendohet se ajo qëndronte midis italishtes dhe rumanishtes. (Ardita Berisha)

DALLKU Armend (1983-). Futbollist. Lindi në Vushtrri, ku edhe nisi të luajë futboll te skuadra “Kosova” e Vushtrrisë. Në vitin 2003 kaloi te skuadra e “Prishtinës” dhe qysh në edicionin e parë fitoi titullin e kampionit të Kosovës. Në edicionin vijues kaloi në Shqipëri, te skuadra e “Elbasanit”, për të cilën zhvilloi 23 ndeshje. Gjatë kohës sa ishte pjesë e “Elbasanit” zhvilloi edhe pesë ndeshje me ekipin U-21 të Shqipërisë, para se të ftohej nga kombëtarja A (2005). Për kombëtaren shqiptare ka luajtur 64 ndeshje. Nga vera e vitit 2005 është pjesë e skuadrës “Vorskla Poltava” nga Ukraina dhe deri më tani ka regjistruar mbi 200 ndeshje, përfshirë këtu edhe garat në Ligën e Europës. Me “Vorskla Poltavan” ka fituar Kupën e Ukrainës në edicionin 2008/09, ndërsa më 2016 u rikthye në KF “Prishtina”. (Arsim Maxhera)

DAMASTIONI. Qytet ilir, ende i paubifikuar. Dëshminë e parë për këtë qytet e ofron Straboni në veprën “Gjeografia”. Damastioni u njoh sidomos përmes monedhave prej argjendi, të cilat janë prerë ndërmjet viteve 400–280 p.e.r. Të gjitha monedhat kanë mbishkrim me shkurtësë në gjuhën greke të emrit të qytetit Damastion. Tipat më të hershme të monedhave mbajnë kokën e Apolonit në avers dhe lyrën në revers. Tipit tjetër i takojnë monedhat që në avers kanë të paraqitur trekëmbëshin dhe në revers kazmën e minatorit me mashën e farkatarit. Mbështetur në numrin e madh të monedhave të gjetura në territorin e Dardanisë antike, ka mendime se qyteti mund të gjendet në këtë areal. (Emine Kalaja-Hajdari)

DAMJANI. Fshat kodrinor-malor i tipit të shpërndarë në lagje, të cilat janë mjaft larg njëra-tjetrës. Shtrihet në lartësi mbidetare 358 deri 410 m, rreth 17 km në juglindje të Gjakovës. Ndodhet në trevën e Hasit, afër maleve të Pashtrikut dhe është vendbanimi kufitar me komunën e Prizrenit. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Një numër i madh i banorëve punon dhe jeton jashtë Kosovës, të njohur si furraxhinj. Në vitin 2011 Damjani kishte 5,133 banorë, ndaj 128 banorëve në vitin 1921. Është qendër lokale e disa vendbanimeve përreth. Ka shkollë 9-vjeçare, qendër shëndetësore, disa njësi tregtare etj. (Qerim Kastrati)

DANÇETOVIQ Vojisllav (Dančetović Vojislav) (1905-1974). Gjuhëtar dhe folklorist serb nga Kosova. Lindi në Vushtrri, ku e mbaroi shkollën fillore. Gjymnazin e kreu në Prishtinë, studimet për gjuhë frënge në Francë dhe u diplomua në Zvicër. Romanistikë studioi dhe në Zagreb. U angazhua si lektor në Seminarin e Albanologjisë në Beograd në vitet 1935-1937. Ka bashkëpunuar me A. Xhuvanin, K. Cipun, E. Çabejn, A. Budën për hartimin e “Fjalor serbokroatisht-shqip” (Tiranë, 1947). Në vitin 1948-49 u zgjodh mësimdhënës për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Beogradit. Mbrojti doktoraturën në vitin 1957 me temën “Sufiksi diminutiv i emrave të gjuhës shqipe”. Botoi artikuj për gjuhën shqipe dhe për folklorin dhe përgatiti përmbledhjen “Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohisë I-II” (Prishtinë, 1952-1963), bashkë me K. Halimin dhe A. Çettën. Bashkë me S. Imamin dhe Gj. Kostiqin është autor i librit për mësimin e gjuhës shqipe për serbë “Bazat e gjuhës shqipe” (Beograd, 1959), autor i studimit “Fjalë të urta shqipe” (Prishtinë, 1971). Hartoi veprat “Gramatikë e gjuhës së sotme shqipe” (fonetika, morfologjia dhe sintaksa), “Historia e letërsisë shqipe” dhe “Poezia epike popullore e shqiptarëve”. (Naile Mala-Imami)

DARA Gavril-i Riu (Gabriele Dara Junior) (1826-1885). Poet, gazetar, politikan. Lindi në Palazzo Adriano. Pasi mori mësimet e para në Seminarin Arbëresh të Palermos (1838-1846), vijoi studimet universitare dhe u diplomua në drejtësi (1849-50). Gjatë tremujorit të parë të vitit 1847 ishte ndër veprimtarët kryesorë të një qarku politiko-letrar që propagandonte ide



GAVRIL DARA

liberale. Në vitin 1848 mori pjesë në revolucionin antiburbon që shpërtheu në Palermo. Bashkëpunoi aktivisht me disa gazeta patriotike, mes të cilave “Il Tribuno”, ku u bë një ndër redaktorët kryesorë. Pas shtypjes së lëvizjes revolucionare, me ftesën e të ungjijt, Nicolò, u transferua në Agrigento për të ushtruar profesionin e avokatit. Këtu njohu Rocco Ricci Gramiton, dajën e Luigi Pirandellos, me të cilin e lidhën idetë dhe projektet e përbashkëta për shndërrimin politiko-kulturor dhe bashkimin kombëtar të Italisë. Të dy bashkëpunuan me të përkohshmen palermitane “Il Baretti” (1856-57) dhe më vonë themeluan në Agrigento të përmuajshmen “La Palingenesi” (1858-1859), ku Dara botoi disa artikuj interesantë letrarë, në të cilët ndihet ndikimi i mendimit politik të Vincenzo Giobertit. Edhe pse nuk mori pjesë vetë në kryengritjet e vitit 1860, Garibaldi e emëroi sekretar të përgjithshëm të guvernatorit (23 qershor 1860), ndërsa pak më vonë kreu detyrën e këshilltarit të klasit të parë. Deri në vitin 1868 mbuloi funksione prestigjioze që e detyruan të zhvendosej vazhdimisht në krahina të ndryshme të Italisë (Palermo, Catanzaro, Bobbio, Aosta, Lugo di Romagna, Trapani). Pasi u kthye në Agrigento, kaloi një periudhë skamjeje që e detyroi të transferohej në Firence, ku qëndroi nga viti 1869 deri në vitin 1874, duke jetuar me të ardhurat që nxirrte falë bashkëpunimit me revista të ndryshme. Në vitin 1875 u kthye përfundimisht në Agrigento, ku kreu detyrën e këshilltarit komunal, të këshilltarit shkollor të provincës dhe të komisarit për antikitetet. Në këtë cilësi të fundit shkroi më 1883 një broshurë arkeologjike për topografinë e Agrigentos, ku u rrek të gjente qytetin antik të Akragasit, për çka Pirandello e futi si personazh të romani i tij “Pleqtë dhe të rinjtë”. Po në atë vit botoi një libër kujtimesh të titulluar “Një shëtitje në Alpe” (Un’escursione sulle Alpi). G. Dara botoi disa vepra letrare në italisht: vëllimin me poezi lirike “Disa poezi” (Alcune poesie, Palermo 1848) kryesisht me motive patriotike; tragjedinë lirike “Francesca da Rimini” (1872) etj. Mes veprave të tjera të Darës vlen të përmendim përkthimin italisht të veprës së De Radës “Anna-Maria

Cominiate”, që është gjetur këto kohët e fundit, si edhe krijimin poetik “Kënka e Lazërit”, teksti i të cilit u rikopjua nga i ati në dorëshkrimet e tij. Dorëshkrimet autografe me vepra të tjera që janë gjetur këto kohët e fundit përmbajnë poezi, sidomos në italisht, të cilat pjesërisht janë botuar nga biografia e tij kryesore Erminia Tuttolomondo. Po këto materiale na lejojnë të rindërtojmë sot fazat komplekse të shkrimit të veprës epiko-lirike që e konsakroi Darën në letërsinë shqipe: “Kënga e sprasëme e Balës”. E shkruar mes viteve 1870-1884, kjo poemë u botua së pari pjesërisht në vitin 1887 nga Zef Skiroi në revistën “Arbri i rii”, e më pas, në vitin 1900 u botua e plotë nga Jeronim De Rada, me të cilin Dara kishte lidhur prej kohësh një letërkëmbim të frytshëm. Vepra përfshinte disa pjesë të shkruara më herët nga gjyshi i autorit, Gavril Dara Plaku, dhe nga i ati, Andrea, megjithëse struktura, stili dhe gjuha e poemës janë punë kryesisht e Gavril Darës së Riut. “Kënga e sprasëme e Balës” mbetet një nga veprat romantike më të mira të letërsisë arbëreshe. (Matteo Mandala’)

DARDANA. Shih: KAMENICA.

DARDANËT. Njëri nga fiset më të mëdha ilire. Ishin banorët më të hershëm të njohur historikisht të Kosovës dhe më gjerë. Rrënjët dardane gjenden në gërshetimin e substratit neolitik dhe adstratit eneolitik indoeuropian. U krijuan gjatë proceseve integruese të epokës së bronzit (2100-1200) dhe e arritën shkallën e formësimit gjatë epokës së hekurit. U paraqitën me kulturë plotësisht të formësuar nga shek. VIII p.e.r., me specifika të kulturës ilire të Gllasinacit. Dardanët banonin në hapësirën midis lumenjve Axios (Vardar), Drilon (Dri), Brong/Margus (Moravë) e Timacus (Timok). Mendohet se etimologjia e emrit të tyre dhe e Dardanisë rrjedh nga gjuha indoeuropiane: dardj-a (shqip: dardha, vend i dardhëve). Në gjirin dardan u përfshinë fiset e galabrëve, thunatëve, daunëve dhe fise të tjera, emrat e të cilave nuk dihen. Fqinjë kishin fiset ilire, si: tribalët, dentelejët, peonët, pellagonët, pirustët, ardiejët, autariatët dhe dasaretët, pastaj mezët e fiset thrake, si medët dhe besët. Dardanët lidhen me dardanët e Azisë së Vogël, ku mendohet se Dardani legjendar themeloi lozën trojane. Ndonëse koha dhe drejtimi i degëzimit dardan nuk janë të qarta, degëzimi mund të shihet në suazat e migrimeve indoeuropiane

të drejtimin lindje-perëndim (mijëvjeçari III p.e.r.) të akejve, drejtimi veri-jug (mijëvjeçari II p.e.r.) dhe dorëve veri-jug (shek. XIII-XII p.e.r.). Migruan edhe në Itali rreth shek. XII p.e.r. Prezencë të shtuar dardane kishte edhe në Daki, sidomos gjatë periudhës romake, kryesisht në rajonet xehtare.

Nga shek. VII p.e.r. dardanët krijuan lidhje intensive tregtare me jugun e zhvilluar (amforat e Hiosit, monedhat e Tasosit etj.), për të marrë hov gjatë shek. VI p.e.r. (vazot me figura të zeza nga Banja e Pejës, Menada e Prizrenit dhe ajo e Tetovës etj.). Gjatë shek. VI-IV zhvilluan fazën paraurbane, të shoqëruar me prodhimtari të dendur zejtare, ndërsa nga shek. IV p.e.r. krijuan një shtet të fuqishëm, i cili ekzistoi deri në pushtimin e plotë romak (mes shek. I). Emrat e njohur të mbretërve dardanë ishin Longari, Bato dhe Monuni. Strukturën shoqërore të shtetit e përbënin: 1. aristokracia skllavopro-nare, në krye me mbretin: priftërinjtë, ushtarakët e lartë; 2. xehtaret, zejtaret dhe tregtarët; 3. fshatarësia e lirë; 4. skllëverit (dulët, robërit e luftës). Pas pushtimeve romake ndryshoi struktura shoqërore dhe kjo përbëhej nga qytetarët e lirë (latinët, peregrinët) dhe skllëverit. Dardanët kishin status peregrini deri në vitin 212, kur u fitua e drejta qytetare romake (Edikti i Karakallës).

Në burimet antike dardanët janë shënuar si popull që vazhdimisht lufton kundër Maqedonisë (gens semper infestissima Macedoniae) dhe kjo vazhdoi më pas dhe kundër pushtimeve romake. Forca e dardanëve buronte nga organizimi i mirë ushtarak, duke i bërë të njohur në botën antike sidomos kalorësit dardanë, andaj nuk është e rastësishme përhapja e kultit të kalorësit. Besimi dardan u zhvillua në faza të ndryshme, duke arritur fazën antropomorfe të paraqitjes së hyjve, duke krijuar mbretërinë qiellore sipas modelit të shtetit të krijuar para pushtimeve romake. Ndonëse shkrimtarët antikë nuk flasin për besimin dardan dhe monumentet e zbuluara epigrafike janë kryesisht të shek. II-III, mendohet se vend të rëndësishëm kishte Hyjnesha Dardane. Rituale religjioze krijuan bazë edhe për zhvillimin e artit skenik-muzikor, siç është vallëzimi hyjnor në monumentin e Dardanës. Dardanët kishin dhe qiellvështrues parahistorikë dhe të mëvonshëm, siç dëshmohet dhe nga labirinti rrethor i Smirës, si paralajmërim i zhvillimit edhe të dijeve kozmologjike. (Edi Shukriu)

DARDANIA. Territor i banuar nga dardanët dhe fiset e tjera. Shtrihej në qendër të Europës Juglindore dhe mori emrin nga vetë dardanët. Territori parahistorik përfshinte hapësirat midis lumenjve Brong (Moravë), Timacus, Axios (Vardar), Astibo dhe rrjedhës së epërme të Drilonit. Në shek. VIII-V p.e.r. ndodh fuqizimi i Dardanisë, i lidhur kryesisht me kompleksin ilir të Gllasinacit. Gjatë shek. VI-IV p.e.r. u zhvillua faza paraurbane, me vendbanime kodrinore me akropole dhe varre luksoze tumulare. Ekonomia mbështetej në bujqësi, blegtori, xehetari, prodhime artizanale, përpunim të metaleve e tregti. Në shek. VI p.e.r. u shpeshuan importet nga bota greke dhe u zhvilluan zejët dhe poçaria në çark, me trajta vendëse e modele helene. U bënë të njohura shpatat mahaira, rrathët prej ari, djathi dardan, dhjami i derrit dhe hekuri e plumbi. Në shek. IV p.e.r. u krijua shteti me territor kompakt, popullsi të njohur me emrin dardan, ushtri të organizuar, institucion të mbretit, fron trashëgues, veprimtari diplomatike dhe martesë dinastike. Territori u zgjerua në hapësirat e autariatëve, tribalëve, taulantëve e peonëve. Përfshirja e territoreve peone e bëri Dardanië fqinje të drejtpërdrejtë me Maqedoninë dhe shkak të armiqësive. U zhvilluan dhe qendrat urbane, të cilat në shek. I p.e.r. Straboni i quan qytete të vjetra (polis arhaia). Qarkullimi i monedhave u intensifikua nga shek. IV p.e.r. me monedhat e Damastionit e deri te denarët e Republikës së Romës. U zhvilluan dijet kozmologjike përmes qiellvështruesve dardanë dhe u krijua mbretëria qiellore.

Dardania bëri aleancë kundër Maqedonisë me romakët e të tjerët dhe bëri politikë të pavarur pas krijimit të Provincës së Maqedonisë (168 p.e.r.). U rezistoi sulmeve romake të viteve 97 p.e.r., 85 p.e.r., 77-76 p.e.r., pësoi disfatë në vitet 75-73 p.e.r. (Lufta Dardane), pas së cilës u gjet në pozitë juridike gjysmë të varur. Dardania i rezistoi një kohë pushtimit të plotë romak, ndonëse triumvirët Antoni (38 p.e.r.) e Krasi (29 p.e.r.) dërguan ushtri në Dardani dhe vetëm më pas u bë pjesë e provincës romake të Mezisë dhe pastaj e Mezisë së Epërme (86). Romakët ndeshën ekonomi e marrëdhënie shoqërore komplekse, që u çrregulluan me shpalljen e pronës bujqësore si pronë publike dhe pronë provinciale. U krijuan prona të mëdha, sidomos latifundet e pronarëve nga Roma, si dhe të veteranëve të vendosur sidomos në

koloninë Scupi. Romakët u përqendruan në shfrytëzimin e xeheve në komplekset xehetare dhe krijuan stacione doganore, të kontrolluara nga perandori. U krijuan dhe stacionet e beneficuarëve konsullarë me karakter ushtarak. Romakët vendosën trupa të shumta ushtarake (Legjioni IV i Skitëve dhe Legjioni V i Maqedonëve, pastaj Legjioni IV i Flavëve etj.). Ndërkohë u formua Ala Vespaziana Dardanorum me 500 kalorës dardanë (mbronte distriktet xehetare) dhe nga latronët dardanë u krijuan 2 kohorta me nga 600 ushtarë (Kohorta Aureliane Dardane I, II). Në vitin 373 u krijuan formacionet e sigurisë (pseudocomitatens), ndërsa nga shek. VI këtë detyrë e kryenin formacionet e sigurisë Scupiensis, Ulpianenses dhe Merenses, nën komandën e magjistratit ushtarak për Ilirikun. Pas reformave të Dioklecianit (279) u krijua Provinca e Dardanisë, me kufij gati të njëjtë me të shtetit dardan. Pas ndarjes së Perandorisë Romake (395), Dardania i takoi Perandorisë Lindore, u bë pjesë e Prefekturës së Ilirikut dhe Dioqezës së Maqedonisë (437). Justiniani e bëri qendër kishtare Justinianën e Parë, si vazhdimësi e Ecclesiae Scupianae. Vikariati përfshinte provincat: Dardania, Moesia Prima, Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Praevalitana, Macedonia Secunda e Panonia Secunda (shek. VI). Pasuria e Dardanisë dhe pozita e saj si kryqëzim rrugësh të rëndësishme solli sulmet e gotëve, të hunëve, të avarëve dhe pastaj të fiseve sllave.

Qytetet e rëndësishme të periudhës romake ishin: Scupi, Naissos, Ulpiana, Arribantion, Viminacium, municipium D. Dardonorum etj. Dardania kishte rrjet të dendur të rrugëve, i cili mundësonte lëvizje të shpejtë të legjioneve, administrim të lehtë dhe shfrytëzim të pasurive natyrore përmes magjistrave Lissus-Naissus, Viminacium-Scupi-Thessalonike, si dhe rrugës që shpinte në Dalmaci. Kishte dhe rrugë vicinale. Në Dardani qarkulluan gati të gjitha monedhat e shek. I-V dhe të perandorëve, të anëtarëve të familjeve të tyre dhe të qendrave të ndryshme. Vlerë të veçantë kanë monedhat e xeheroreve dardane të fillimit të shek. II, të Ulpianës dhe të minierave të Kopaonikut (këto të fundit me mbishkrim "Dardanici"). Mënyra e varimit përfshin sarkofagët luksozë prej mermeri, ato me tulla e deri tek ato tumulare. Objektet artizanale pasqyrojnë zhvillim kulturor, me gërshetim të traditës e frymës romake. Onomastika është ilire, por ka dhe

emra thrakë dhe të dëshmuar vetëm në Dardani (Ambia, Pitta, Bubita, Ettela, Ninis etj.). Traditës i takojnë Hyjnesha Dardane, Andini, hyjt kalorësiakë e hyji thrakas Zbeltiurdi, ndër-sa këtyre iu bashkëngjitën ata romakë e orientalë, shpesh në interpretim vendor: Jupiteri, Minerva, Fortuna, Merkuri, Diana, të lindjes Mitra, Izida, Serapisi, Jupiter Doliheni e helen Nemezisi, Hekata, Asklepi, Telesfonti etj. (Edi Shukriu)

DARDANISHTJA. Gjuhë e dardanëve të lashtë që jetonin në Ballkanin Qendror. Shumë studiuues i konsiderojnë ilirë, disa trakas. Ndonjë prej studiuesve konsideron se gjuha e tyre ka qenë e veçantë, por nuk ekziston asnjë dokument i shkruar. Materialet onomastike Dardaninë dhe dardanët i ngërthejnë në hapësirën ilire. Etimologjia e emrit Dardani lidhet me fjalën “dardhë” të gjuhës shqipe. Katiçiqi, mbështetur në të dhënat onomastike, e fut dardanishten në ilirishten qendrore. Përgjithësisht dardanët trajtohen si fis ilir, prandaj edhe gjuha e tyre shihet brenda këtij kuadri. (Bardh Rugova)

DARDHA. (*Pyrus* sp) Bën pjesë në familjen trëndafilore (*Rosaceae*). Kultivimi i dardhës në Kosovë është i njohur që nga lashtësia. Kultivarët më të njohur dhe më të përhapur janë: Bukuroshja e qershorit, Laramania e korrikut, Starkrimson, Williams, Viliami i kuq, Abate Fettel, Conference, General Leclerc, Cure (Murgesha), Santa Maria, E hershmja e Moretinit, Klerzho, Passe Crassane, Tosca, Eliot, Nashi (dardha japoneze dhe autoktone); Polloshka e bardhë, Tiranaska, Dardha Hase. Nënshartesat gjenerative më të përhapura janë: dardha e egër, dardhukla, ukere, gjethe mështekne, usuriane, kineze, kaleriane, gjethe shelgu, farishtet e murrizit dhe vegjetative, ftoi MA, BA 29, OHF 333, Sydo, Sydo INFELL 344, Ftoi MC, Adams. Zgjerimin e dardhës në Kosovë e ka kufizuar shfaqja e bakterit (*Erwinia amylovora*), shkaktari i djegies bakteriale të pemëve. (Agim Zajmi)

DASMA. Është gazmendet familjare, që organizohet me rastin e martesës dhe konsiderohet të jetë ndër ngjarjet më të rëndësishme të jetës familjare dhe çiftit që martohet. Dasmës tradicionalisht, me përjashtim të rasteve të grabitjes së nuses, i kanë paraprirë ritet e fjalës dhe të fejesës. Në Kosovë me emrin e njëjtë cilësohet edhe ceremonia e ritit të

rrethprerjes, apo siç njihet në popull “dasma e synetisë”. Dasmat me rastin e martesës, si gazmende familjare, zakonisht janë të hapura edhe për farefisën, fqinjët dhe të afërmit e ftuar nga i zoti i dasmës, por jo detyrimisht. Sipas traditës, dasma fillonte tri ditë deri një javë para ditës së marrjes së nuses, që quhet dita e dasmës. Familjarët ftoheshin, veçanërisht bijat e familjes të martuara në lagje apo vendbanime të tjera. Duke qenë se në Kosovë ende dominon familja patrilineare dhe patrilokale, ditën e dasmës krushqit radhiten në vetura dhe secila veturë ka një peshqir, në mënyrë që dasmorët të dallohen nga ata që nuk e gëzojnë këtë status. Njëra nga këto vetura ruan vendin e nuses, që quhet “kerri i nuses”, dhe dallon, sepse është e dekoruar më shumë se veturat e tjera. Për shkaqe krejt praktike, ceremonitë e dasmës organizohen në objekte hoteliere, në salla dhe restorante. Kjo zhvendosje e lokacionit të organizimit të dasmës ka ndikuar edhe në qasjen e shtëpiakëve ndaj obligimeve që zakonisht binin mbi ta, kur dasmat organizoheshin në shtëpi. Në zonat urbane, sidomos në qytetet e mëdha, çifti e disenjon dasmën e vet, duke e zbukuruar dhe pasuruar atë me përmbajtje argëtuese për mysafirët. Në zonat më të thella dhe më pasive në Kosovë, ku dasmat e kanë ruajtur stilin tradicional të otomanizimit, shpalosin pasurinë e trashëgimisë kulturore, zakonet, veshjen dhe folklorin. Muzika e preferuar e rapsodëve të dikurshëm shpaloset zakonisht në fund të dasmave, që quhet “sofra”. Familja që e marton të bijën e vet është e kursyer nga ceremonitë e gjata dhe prania e dasmorëve. “Dasma e synetisë”, apo festa e ritit të rrethprerjes, njësoj si dasma e martesës, para luftës së fundit ishte më e thjeshtë. Kjo shpjegohet edhe me rrethanat sociopolitike dhe ekonomike të rënduara, të cilat dominuan gjatë viteve ‘90. Dasmat vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm të kohezionit shoqëror, nëpërmjet të cilave forcohet rrjeti shoqëror dhe rritet solidariteti. (Elife Krasniqi)

DAUNËT. Njëri ndër katër fiset kryesore dardane. Të bashkuar me dardanët, galabrët e thunatët, krijuan territor kompakt, i cili u quajt Dardania. Në këtë territor u krijua shteti (shek. IV p.e.r. - I), formacioni politik më i fuqishëm i Ballkanit Qendror, i cili i rezistoi për kohë të gjatë edhe pushtimit romak. Sipas autorëve antikë, një pjesë e daunëve migroi në Italinë

Jugore (në kapërcyell të mijëvjeçarëve II-I p.e.r.), bashkë me galabrët dhe thunatët, fise dardane. (Emine Kalaja-Hajdari)

DAUTI Daut (1961-). Gazetar, shkrimtar. Lindi në Bojanë të Shkupit. Shkollimin fillor e ndoqi në vendlindje, në Ohër dhe në Shkup. Shkollën e mesme dhe Fakultetin e Gazetarisë i kreu në Shkup. Disa vjet punoi në gazetën “Flaka e vëllazërimit” (1988-2004), gazetar, redaktor dhe kryeredaktor. Ka qenë korrespondent i Radios “Dojçe Velle” nga Shkupi dhe bashkëpunëtor në gazeta, revista dhe publikime në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Është autor i librave me poezi: “Ëndërr e përdalë”, “Shartimi i ëndrrës”, “A vdes ëndrra”; pastaj i librave me tregime: “Baseni i troftave në Malin e Thatë”, “Sytë e mësyshit” dhe autor i librit “Shqiptarët e Ukrainës” (me bashkautor Sefer Musliun). Është aktivist për liritë dhe të drejtat e njeriut. Prej vitit 2009, në dy mandate, është anëtar i Komisionit për Verifikimin e Fakteve, i njohur si Komisioni për Lustrim, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (Salajdin Salihu)

DAUTI Esad (1937-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku mori edhe arsimin bazë. Në Universitetin e Shkupit fillimisht kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike (drejtimi biologji-kimi), më pastaj degën e biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të po këtij universiteti. Magjistroi dhe doktoroi në fushën e shkencave të biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Zagrebit. Një kohë mbajti mësim në shkollën ekonomike dhe normale të Ferizajt, më vonë u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, pastaj në degën e biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëroi lëndët ekologji animale dhe metodikë të mësimdhënies. Botoi punime shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare dhe mori pjesë me kumtesa në konferenca dhe tubime të tjera. Është autor i disa teksteve për shkollën e mesme dhe fillore. Ka qenë delegat i Kuvendit të Kosovës (1969-1974) dhe deputet i Kuvendit të Kosovës në vitin 2001. (Behxhet Mustafa)

DAUTI Gani (1949-2005). Inxhinier i makinërisë. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesmen teknike. Në vitin 1975 diplomoi në Fakultetin Teknik të Universitetit

të Prishtinës. Në fillim punoi në kombinatin “Trepça” si inxhinier praktikant, më pastaj kaloi të punojë në Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë, si inxhinier në sektorin e zhvillimit (1976-1983). Më vonë në këtë fabrikë u zgjodh drejtor i përgjithshëm, detyrë që e kreu deri në vitin 1988. Më pas, në periudhën 1988-1999 kreu punë të ndryshme për mbijetesë. Në vitin 1999, me kërkesën e punëtorëve u kthye në Fabrikën e Amortizatorëve, ku bashkë me stafin e atëhershëm teknik dhe punëtorët me përvojë, arritën rikthimin e prodhimit të amortizatorëve dhe liferimin e tyre në treg. (Fehmi Krasniqi)

DAUTI Hilmi (1951-). Mjek, anatomist, profesor universiteti. Lindi në Deçan, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Pejë. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1975). Më 1977 u zgjodh asistent i lëndës së anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Studimet pas-universitare i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1980). Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë



HILMI DAUTI

në Prishtinë (1981). Emërohet docent, profesor inordinar, profesor ordinar (1994) i lëndës anatomia e njeriut në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në periudhën 1988-1989 qëndroi në Hjuston, SHBA për perfeksionim profesional pasdoktoral. Ishte drejtor i Institutit të Anatomisë, drejtor i instituteve mjekësore të QKUK-së, si dhe në funksione të tjera në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2014 u zgjodh dejtore për çështje akademike në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe i tekstit universitar nga fusha e anatomisë. Që nga viti 1994 është profesor i rregullt i anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Bajram Nuraj)

DAUTI Mustafë (1936-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Pejë, arsimimin bazë e kreu në vendlindje, studimet i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës (1974). Po në këtë universitet mbrojti edhe tezën e disertacionit (1978). Një kohë

punoi mësimdhënës në Shkollën e Mesme Bujqësore dhe Shkollën e Lartë Bujqësore në Pejë. Në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës fillimisht u zgjodh ligjërues për lëndën pedologjia me bazat e gjeologjisë. Po për këtë lëndë avancohet edhe në titujt e tjerë universitarë. Për qëllime studimi ka qëndruar në disa shtete të Europës. Ka botuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale në fushën e studimit të tokës. (Xhevdet Elezi)

DE RADA Jeronim (1814-1903). Poeti themelues i romantizmit arbëresh dhe i vetëdijes së re kulturore e identitare arbëreshe, publicist, folklorist, estet, filolog e mësues i shquar i shqipes.



JERONIM DE RADA

Lindi në Maq, Shëmitër Korone, qendër e kolegjit arbëresh të Shën Adrianit ku dhe nisi studimet më 1822, nën kujdesin e të atit, prift ortodoks, mësues i gjuhës greke e latine. Studioi me pasion letërsinë antike dhe moderne, me ide ilumi-

niste e frymë romantike, e cila nuk e braktis kurrë. Qysh në rini çmoi e mblodhi folklorin arbëresh. Poet i vetëdijshëm e i kultivuar, krahas krijimtarisë së pasur letrare pati një jetë të angazhuar, nga politika reale te ajo kulturore. Nis studimet për drejtësi në Napoli më 1834, ku si shumë arbëreshë përfshihet në lëvizjet antiburbone. Si komplotist provon arratinë dhe burgun. Rikthimi në Napoli më 1840. Punësimi si mësues pranë aristokratëve Spiriti, dhuna dhe dështimet revolucionare e ftohën ndaj lëvizjeve radikale dhe zbehin frymën iluministe, gjë që e shpreh edhe në shkrimet e “L’Albanese d’Italia” (Arbëreshi i Italisë) 1848, gazeta e parë e shtypit shqiptar, themeluar prej tij. Mbyllja e gazetës, konservatorizmi i De Radës së zhgënjyer e bëjnë të tërhiqet në vendlindje, ku tashmë mësues në kolegjin e Shën Adrianit, përurojnë mësimin e shqipes më 1849, detyrë që e kreu me përkushtim gjithë jetës. Martesa më 1850 dhe krijimi i familjes janë oaza e tij e re. Vitet ’60 shenjojnë një fazë të re. Pas traktatit “Parime të estetikës” (Principi di estetica 1861), refleksion estetike i tipit romantik, boton veprat “Lashtësia e kombit shqiptar” (L’Antichità della nazione albanese, 1864) dhe “Rapsodi të një poeme arbëreshe” (Rapsodie d’un poema albanese, 1866), si përpyetje për dëshmim gjuhësor, historik e

estetik në funksion të çështjes kombëtare. Thelmon “Fiamuri Arbërit” (1883-1887), revista e parë e shtypit shqiptar, mbështetëse e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, integritetit territorial etj. Promotor i dy kongreseve gjuhësore të shqipes, 1895 e 1897, në artikujt dhe dy gramatikat e veta, “Gramatikë gjuhës shqipe” (Gramatica della lingua albanese, 1870 dhe 1894), synoi dëshmimin e origjinës së lashtë të kombit përmes “mitit pellazgjik” dhe mëvetësisë së shqipes në funksion të ideologjisë nacionaliste të Rilindjes. I mundur nga fatkeqësi të shumta familjare, ndërroi jetë, gjithnjë si mësues i shqipes, më 28 shkurt 1903. Vepra letrare e De Radës çeli epokën e artë të letërsisë arbëreshe, por edhe atë moderne kombëtare, duke sprovuar gjuhën shqipe në nivelet më të larta të poezisë dhe duke shkruar ndjeshmërinë romantike evropiane me modele të folklorit arbëresh në një sfond historik nacional. Përshkohet nga lirizmi i thellë edhe në rrekjet më epike. Talent i rrallë, njëheri i pakënaqur me çka krijonte, i rikrijoi veprat në vijimësi. Kryevepra e De Radës mbetet botimi i parë i “Këngëve të Milosaos” (Poesie Albanesi del secolo XV, Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari, 1836), pavarësisht botimeve të 1847 e 1873. Ia falin këtë epërsi: natyra thellësisht lirike e tekstit poetik, zbulimi i subjektives, fragmenti si poetikë e dendësimit, gjuha e habitshme dhe zbuluese, forca sugjestive e vargut dhe botës deradiane si zbulimit epifanik i vetes, natyrës dhe botës. Në zemër të kësaj estetike të pashembullt qëndron dashuria “e pamundur” mes Milosaos e Rinës, me kulmime emocionale në 20 këngët e para të veprës. Lumturia e martesës së tyre, falë tërmetit që rrafshon qytetin, thyhet ritmikisht në 10 këngët e fundit nga vdekja e birit të dashur dhe Rinës së dëshpëruar, duke kulmuar në trajta elegjiake të humbjes, deri te vdekja e Milosaos në luftë kundër turqve, gjest atdhetar, por ku jeta lihet si në “ëndërrëz”. E pamundur shfaqet dashuria edhe në “Këngët e Serafina Topias” (Canti storici albanesi di Serafina Thopia, moglie del principe Nicola Ducagino, 1839), ripunuar fort më 1843, e vendosur po në sfondin e qëndresës kundër turqve. Si një ditë lirik, vepra sjell fatin tragjik të heronjve mbërthyer mes ndjenjës e detyrës, por edhe një pamundësi lumturie në prag të shembjes së madhe të Arbrit: hareja e pafajësisë rinore ku lind dashuria e Bozdarit me Serafinën, e cila martohet me princ Dukagjinin për hir të bashkimit të dy familjeve bujare në qëndresë kundër

armikut, fiket drejt melankolisë e vdekjes mbas martesës, prej pengut të dashurisë. Në botimin III, ajo vjen si “Uno Specchio di umano transito” (1898), me ekuilibër strukturor më të madh. Titulli “Pasqyrë e jetës njerëzore” i përgjigjet edhe konceptit kristian të ekzistencës njerëzore si shtegtim i jetës në vdekje. Ndërsa “Skanderbeccu i pafaan”, botuar me 5 libra nga 1872 deri 1884, është vepra më e menduar dhe e punuar prej poetit, projekt epik kombëtar që rreket të rindërtojë heroikën e “Motit të madh”. Heroi paraqitet rrallë në vepër e rroket më tepër si përgjithësim. Poetika deradiane mbështetet në modele rapsodike arbëreshe dhe lidh historinë me përfytyrimet e përjetimet e thella autoriale. Ndonëse sprovë më epike, vepra përshkohet nga lirizmi i gjendjes shpirtërore të personazheve, të cilët, mbërthyer prej fatit historik e personal, zhyten në melankoli. Krijimtaria e De Radës shfaq një simbiozë specifike mes trashëgimisë klasiko-ortodokse me tonet e romantizmit të thellë, shprehur në tragjiken e fatumit të qenies e sidomos të qenies së dashuruar.


Vepra të tjera të De Radës përmendim: “Rrëfimet e Arbërit” (Storie d’Albania dopo il 1460, 1848); tetralogjia me katër novela në vargje: “Annamaria Cominiante, La notte di Natale, Adine, Videlaide; veprat në italisht: “L’Odisse” (Odissea, 1846) sprovë rinore me temë shqiptare; dramat historike “Numidët (I Numidi, 1846) dhe “Sofonisba” (1891-1892), “Autobiografia” (Autobiologia 1898-1899); “Testamenti politik” (Testamento politico, 1902) etj. (Persida Asllani)

DE SIMONE Karlo (Carlo De Simone) (1932-). Gjuhëtar italian indoeuropianist, specialist i greqishtes së vjetër, i latinishtes dhe i mbishkrimeve mesape e etruske. Lindi në Romë, ku i mbaroi studimet (më 1950) për gjuhësi krahasimtare dhe arkeologji. Doktoroi më 1955 në Universitetin e Romës me temë për mbishkrimet mesape: kronologjinë dhe fonetikën e tyre. Ka specializuar në Tybingen, ku punoi si asistent gjatë periudhës 1961-1964. Pas habilitimit, profesor i gjuhësisë krahasimtare në Universitetin e Vjenës (1972-73) dhe në Universitetin e Peruxhas, Itali (1975-1980). Prej vitit 1980 punoi në Universitetin e Tybingenit. Shquhet si studiues i gjuhëve të lashta të Gadishullit Apenin, sidomos për etruskët dhe mesapët, të cilët nga disa studiues shihen në lidhje me ilirët. Në studimin “Ilirët e jugut. Sprovë për një përkufizim” (Gli illiri del Sud.

Tentativo di una definizione, 1986) flet edhe për reflekset e tektaleve *ie*. (Bardh Rugova)

DECENTRALIZIMI FISKAL. Shpërndarje apo delegim i pushtetit nga niveli qendror në nivele më të ulëta. Qëllimi kryesor i decentralizimit është të thjeshtësojë dhe lehtësojë procedurat burokratike, në mënyrë që të ofrohen shërbime më të mira për qytetaret, si dhe të arrihet rritje ekonomike dhe zhvillim. Llojet e decentralizimit përfshijnë sektorët politikë, administrativë, fiskalë, të tregut etj. Në Kosovë decentralizimi i pushtetit lokal është një ndër pikat kryesore në Planin e Marti Ahtisarit, mbi të cilin është shpallur pavarësia e Kosovës. Me këtë decentralizim një varg përgjegjësish janë deleguar te komunat. Po ashtu, decentralizimi fiskal rrit efikasitetin ekonomik, sepse qeveritë lokale (komunat), në raport me qeverinë qendrore kanë mundësi më të mira për të ofruar shërbime publike, për shkak të afërsisë me qytetarët dhe përparësisë së shkëmbimit të informatave. Karakteristikë e decentralizimit fiskal në Kosovë është se komunat e caktojnë vetë lartësinë e tatimit mbi pronën dhe, duke mbledhur edhe disa taksa dhe kontribute të tjera ose licenca dhe shërbime të ndryshme, sajojnë vetë buxhetin e tyre. Megjithatë, komunat marrin edhe një grant nga buxheti qendror për nevojat e arsimit dhe të shëndetësisë. (Valon Murtezaj)

DEÇANI. Qytezë në pjesën qendrore të Rrafshit të Dukagjinit, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Deçani ka pozitë shumë të mirë gjeografike, ngase është i vendosur në anën e djathtë të lu-



DEÇANI

mit Bistrica, në rrugën Pejë-Gjakovë-Prizren. Si qendër komunale u themelua në vitin 1963.

Në vitin 2011 kishte 3,803 banorë, ndaj 1,734 banorëve në vitin 1918. Është i banuar që nga kohërat më të lashta. Si vendbanim i vjetër përmendet në krisobulën e vitit 1330. Emërtimin Deçan e hasim në hartat e M.V. Koronelit (Coronell) të vitit 1668 me emër Daciani. Në Deçan dhe rrethinë ekzistojnë gjurmët e disa objekteve të lashta të kultit dhe tumave ilire, materialet dekorative nga stolitë deri te stelat etj. Në afërsi të qytetës gjendet objekti i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore Manastiri i Deçanit. Që nga kohët e hershme e deri më sot përpunimi i drurit ka qenë dhe është traditë e këtyre banorëve. Deçani është i njohur edhe si vend turistik dhe qendër rekreative. Veçohet me motive natyrore (klimatike, hidrografike, biogeografike) dhe antropogjene (kulturore e historike, manifestacionale, etnosociale). Në këtë qytezë janë të vendosura institucionet e nivelit komunal, administrata komunale, qendra shëndetësore e mjekësisë familjare, shtëpia e kulturës, shërbimet bankare etj. Në Deçan funksionojnë edhe disa institucione arsimore, kopshte, shkolla fillore dhe të mesme (gjimnazi dhe shkolla e mesme teknike) etj. (Qerim Kastrati)

DEÇANI (komuna). Komunë në pjesën perëndimore të Kosovës, me qendër qytezën me të njëjtin emër. Shtrihet në të dy anët e Bistricës së Deçanit, në Rrafshin e Dukagjinit. Territori i komunës zë sipërfaqen prej 294 km², prej tyre 8,940 ha tokë pjellore, 14,420 ha pyje, 5,479 ha kulloso. Ka pozitë të mirë geografike, ngase gjendet ndërmjet qyteteve Pejë dhe Gjakovë. Lartësia mbidetare e territorit të komunës së Deçanit lëviz nga 473 m deri në 2,656 m, kurse maja më e lartë është ajo e Gjeravicës. Kufizohet në perëndim me Republikën e Shqipërisë, në veriperëndim me Malin e Zi, në veri me komunën e Pejës, në juglindje dhe jug me komunën e Gjakovës dhe të Junikut. Nga ana fiziko-geografike paraqiten forma të ndryshme relievoe dhe shumëllojshmëri të peizazhit. Përbëhet nga dy zona të veçanta: zona e Rrafshit të Dukagjinit dhe zona e Bjeshkëve të Nemuna. Relievi i lartë i copëzuar nga gryka të shumta dhe lugje ka ndikuar edhe në klimë, hidrografi, bimësi, si dhe në shtrirjen e popullsisë dhe ekonomisë. Format më të njohura relievoe janë gryka e Deçanit dhe gryka e Lloçanit. Gryka e Deçanit gjendet ndërmjet maleve të Strelcit në veri dhe maleve të Deçanit në jug. Gjatësia e grykës është 12 km, me shpate vertikale në të

dy anët dhe e mbuluar me lloje të ndryshme të drunjve. Me ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë, nëpër këtë grykë, distanca ndërmjet këtyre dy qendrave shkurtohet në 36 km. Kushtet klimatike ndërmjet ultësirës dhe pjesës malore ndryshojnë dukshëm. Në Deçan (lartësia mbidetare 570 m) temperatura mesatare vjetore është 9.4^o C, maksimale 20.6^o C, ndërsa ajo minimale është -2.2^o C. Zona është e pasur me burime të shumta dhe të fuqishme, lumenj dhe liqene akullnajore. Lumi kryesor është Bistrica e Deçanit, degë e djathtë e Drinit të Bardh, me gjatësi 53 km dhe prurje mesatare 5.6 m³/sek. Hapësira malore e komunës është e pasur me lloje bimore endemike dhe relikte, si dhe me lloje të faunës së egër, tërheqëse për turizëm. Komuna e Deçanit ka një qendër urbane, 10 qendra lokale dhe 37 fshatra. Numri i popullsisë në vitin 2011 ishte 40,019 banorë, ndaj 25,582 banorëve në vitin 1961. Nga aspekti ekonomik, komuna është tipike bujqësore dhe blegtorale dhe merret kryesisht me kultivimin e gjedhit, deles dhe shfrytëzimin e drurit. Ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, pemëtarisë dhe bletarisë. Degë e rëndësishme ekonomike është edhe turizmi. Një numër i madh i banorëve nga kjo komunë punojnë dhe jetojnë jashtë Kosovës. (Qerim Kastrati)

DEDA Xheladin (1908-1971). Mjek, klinikist, oftalmolog, ligjërues. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën tetëvjeçare. Gjimnazin e kreu në Shkodër. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua



XHELADIN DEDA

në Fakultetin e Mjekësisë në Romë (1931-1937). Punoi disa vjet si mjek i përgjithshëm në Tropojë. Më 1942 u specializua për okulistikë në Romë. Pas një qëndrimi të shkurtër në Tiranë, kthehet në Kosovë, ku punon deri në vitin 1946. Në atë kohë në Tiranë kishin filluar përpjekjet nismëtare për hapjen e Fakultetit të Mjekësisë. Më 1948, pas mbylljes së kufirit me Shqipërinë, Xh. Deda kthehet përfundimisht në Kosovë, e cila në atë kohë nuk kishte asnjë oftalmolog. Në spitalin e Prishtinës afirmohet shumë shpejt si oftalmolog jo vetëm në Kosovë, por edhe me gjerë. Kishte pacientë nga Sanxhaku, Nishi, Beogradi, por edhe nga Zagrebi dhe Italia. Ai formoi një ekip mjekësh dhe i hodhi themelet

e shërbimit të oftalmologjisë në Kosovë, mbi të cilat më vonë u ngrit Klinika e Oftalmologjisë e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Xh. Deda ishte pjesëmarrës në shumë tubime e konferenca shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Ishte bartës i shumë dekoratave dhe mirënjohjeve. Vdiq në Beograd në vitin 1971, tri ditë pas operacionit nga kolecista. U varros me nderime në Prishtinë, me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme të shumë qytetarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare. (Isuf Dedushaj)

DEDAJ Gjergj (1954-). Politikan, sociolog. Lindi në Guskë të Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Gjakovë. Diplomoi në Universitetin e Prishtinës, në degën për filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik. Punoi mësimdhënës në shkollat e mesme të Prishtinës. Në vitin 1991 themeloi Partinë Liberale të Kosovës, ku u zgjodh sekretar i përgjithshëm. Kryetar i Partisë Liberale të Kosovës (PLK) u zgjodh në vitin 1993. Në vitin 1998, në zgjedhjet e organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës, u zgjodh deputet dhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës. Ishte pjesëmarrës i raundit të dytë të bisedimeve të Rambujesë, ndërsa pas luftime ishte anëtar i Këshillit Transitor të Kosovës. Gjatë viteve 2004-2007 ishte deputet i Kuvendit të Kosovës. Në vitin 2006 u zgjodh nënkryetar i Internacionales Liberale me seli në Londër. Ushtri edhe funksione të tjera në institucionet e Republikës së Kosovës. (Nerxhivane G. Dauti)

DEDAJ Rrahman (1939-2005). Poet. Lindi në fshatin Penuhë të Podujevës. Kreu Normalen në Prishtinë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Në



RRAHMAN DEDAJ

fillim punoi si gazetar në Radio Prishtinë, pastaj si redaktor në Shtëpinë Botuese "Rilindja", më pas ushtri funksione të ndryshme politike në institucionet e Kosovës. Botoi një numër vepërash, kryesisht poezi dhe letërsi për fëmijë:

"Me sy kange" (1962), "Msheftësia" (1966), "Medaljoni" (1966), "Dy liqe" (1967), "Simfonia e fjalës" (1968), "Baladë e fshehur" (1970), "Zogu dhe kulla" (1972), "Etje" (1973), "Gjërat që s'preken" (1980), "Koha në unazë"

(1980), "Jeta gabon" (1983), "Fatkeqësia e urtësisë" (1987) dhe vëllimin "Zoti thotë ndryshe Adam" (2006), që u botua pas vdekjes së poetit, me vargjet e lëna dorëshkrim. Poezia e Rr. Deda, sidomos ajo e fillimeve, rrezaton një lirizëm të qetë, që vjen kryesisht nga malli për vendlindjen dhe kërkshëria për të hulumtuar të kaluarën historike të etnisë dhe të truallit, por edhe fatin e së nesërme të atyre që po ecin tehet të një rreziku, shtegut të ngushtë të një unaze. Vargjet e shkruara në mbyllje të shekullit njëzet dhe në vitet e para të shekullit njëzetënjë, të përmbledhura dhe të botuara pas vdekjes, përbëjnë kryeveprën e autorit, përkatësisht një nga vëllimet poetike me peshë në letërsinë shqipe. Brenda këtij vëllimi hasim vargje nga më dramatiket të poetit. Është poezi e ngjizur dhe ngarkuar nga një dëshpërim i madh. Burimi i kësaj ndjenje të zërit lirik vjen: i dëbuar dhunshëm nga vendlindja (poeti që nga lufta e vitit 1999, deri në vdekje jetoi në Londër), i pafuqishëm të vërë dorë mbi fatin e vet, të familjes së tij, të atdheut dhe etnisë së vet, vetmia e poetit do të jetë përmasash nga më të dhimbshmet në poezinë shqipe. Edhe pse i njohur si lirik me qetësi të brendshme, i përmbajtur edhe përballë sfidash të rënda gjatë jetës, te vargjet e lëna në dorëshkrim, në vend të huaj dhe i vetmuar, sado i përmbajtur, klithja e zërit skofiar, me këtë rast vjen shpërthyes. Nuk mungojnë vargjet me reflekse persiatëse, filozofike që shprehin dëshpërim e zhgënjim ndaj një fatumi universal, të prerë apo të paracaktuar. Poezia e Rr. Deda u përkthye dhe u vlerësua në hapësirën e ish-Jugosllavisë. (Ali Aliu)

DEDI Ahmet (1945-2007). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Dediq të komunës së Medvegjës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen në Beograd. Kreu studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1973). Punoi në shkollën e mesme teknike "19 Nëntori" gjatë viteve 1969-1973 në Prishtinë. Një kohë ishte i angazhuar asistent në degën e makinerisë të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1973 kaloi me punë në Fabrikën e Amortizatorëve, ku më vonë u zgjodh drejtor i prodhimit. Më pas kaloi me punë në Fabrikën "Metallac" në Janjevë, si drejtor i përgjithshëm. Pas vitit 1991 u largua nga puna dhe jetoi jashtë vendit. (Fehmi Krasniqi)

DEDI Veli (1912-1995). Pjesëmarrës i Luftës Qytetare të Spanjës, hero i popullit në Shqipëri. Lindi në fshatin Dediq të Tupallës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Vrajë. Studioi në Akademinë e xhenios në Firencë të Italisë. Më 1932 emigroi në Shqipëri. Më 1936 shkoi në Spanjë, merr pjesë në Luftën Antifashiste. Gjatë viteve 1939-1940 sistemohet në kampet antifashiste, ndërsa nga vitet 1941-1944 merr pjesë në luftën antifashiste në Francë, si komandant i forcave guerile në Marsej. Më 1944 hap frontin e luftës në Marsej për çlirimin definitiv të Francës Jugore. Më 1946 kthehet në Shqipëri me gradën e majorit të ushtrisë franceze. Emërohet drejtor i Xhenios në Ushtrinë Shqiptare, ku avancohet në gradën e gjeneralmajorit dhe merr titullin Hero i Popullit. Emërohet komandant i Garnizonit të Tiranës. Gjatë viteve 1952-1962 ishte drejtor i Arkivit Shtetëror të Shqipërisë. Ka merita për shpëtimin nga shkatërrimi të lëndës arkivore të Komitetit të Kosovës dhe të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Pas pensionimit u zgjodh sekretar i përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të LANÇ-së. Një rrugë në Marsej mban emrin e tij. Vdiq në Tiranë. (Hakif Bajrami)

DEDUSHAJ Isuf (1951-). Mjek, epidemiolog, profesor universitar. Lindi në Vuthaj, në Mal të Zi. Shkollimin fillor e kreu në Vuthaj dhe Guci, gjimnazin në Pejë (1970), ndërsa Fakultetin e



ISUF DEDUSHAJ

Mjekësisë në Prishtinë (1976). Punësohet në Entin Krahinor për Mbrojtje Shëndetësore dhe njëkohësisht punon si mësimdhënës në shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë (1975-1985). U zgjodh asistent i mjekësisë sociale në Fakultetin e Mjekësisë dhe më pas specializoi për epidemiologji (1980), duke u bërë epidemiologu i parë shqiptar në Kosovë. Studimet pasuniversitare i kreu në Sarajevë, ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1986). Më pas avancohet në titujt përkatës dhe më 1998 u zgjodh profesor ordinar i epidemiologjisë, i shëndetit publik dhe i etikës. Ishte përgjegjës i sektorit për imunizim për Kosovë, pjesëmarrës në shumë forume dhe organizata të kësaj fushe

në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. Në periudhën 1986-1990 ishte kryeshef i Institutit të Epidemiologjisë, kryeredaktor përgjegjës i revistës “Shëndeti” (1981-1990), redaktor përgjegjës për librin universitar nga fusha e mjekësisë në Universitetin e Prishtinës (1992-1997), pastaj kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës (1992-2001) etj. Pas luftës ushtroi detyrën e drejtorit të departamentit të epidemiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, pastaj të drejtorit të këtij instituti (2001-2006), si dhe dekan i Fakultetit të Mjekësisë në vitet 2006-2007. Është autor i disa monografive shkencore dhe teksteve universitare: “Vaksinimet kundër sëmundjeve ngjitëse” (1994), “Epidemiologjia, parimet dhe praktika” (1997), “AIDS-SIDA, sëmundje që vret” (1998), “Imunoprofilaksia” (2002), *Epidemiologjia speciale e sëmundjeve ngjitëse* (2005), “Figura të ndritura të mjekësisë shqiptare” (2015) etj. Botoi shumë punime shkencore dhe profesionale, si autor dhe bashkautor, në revista dhe publikime brenda dhe jashtë vendit. Është bashkautor i zbulimit të genomit të virusit të EHKK-së i emëruar “Kosova Hoti”. (Avdyl Krasniqi)

DEDUSHAJ Jeton (1975-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Vuthaj në Mal të Zi. Gjatë viteve 1997-1998 ishte një ndër organizatorët e protestave në lagjen “Kristal” në Pejë. Që nga 5 qershori 1998 iu bashkua radhëve të UÇK-së në Zonën e Dukagjinit, ku mori pjesë në betejat e zhvilluara në Loxhë, Prilep, Gllgjan, Vrellë, Pozhar, Lumbardh etj. Ishte luftëtar i Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla” të UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit. Ra dëshmor më 5 qershor 1999 në njërin ndër betejat më të rrepta që i zhvilloi UÇK-ja në vijën e parë të frontit Dashinoc-Lumbardh-Pozhar. (Fetnete Ramosaj)

DEFICITI BUXHETOR. Tejkalmimi i shpenzimeve buxhetore ndaj të ardhurave buxhetore. Ky term më së shumti përdoret për t’iu referuar shpenzimeve të qeverisë, e shumë më pak për firma apo individë. E kundërta e deficitit buxhetor do të ishte suficiti (teprica) buxhetor, me ç’rast të ardhurat buxhetore janë më të larta sesa shpenzimet buxhetore. Nëse të ardhurat buxhetore janë të barabarta me shpenzimet buxhetore, thuhet se buxheti është në ekuilibër apo i balancuar. Deficiti buxhetor zakonisht

paraqitet si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto, e cila mund të zvogëlohet në periudhat e zhvillimit ekonomik, si rezultat i rritjes së të ardhurave buxhetore, papunësisë në rënie dhe nevojës më të vogël për shpenzime qeveritare. Në anën tjetër, deficitin buxhetor mund të rritet në situatat e rënies ekonomike, për shkak të uljes së të ardhurave buxhetore dhe nevojës për shpenzime më të larta qeveritare. Vendet mund ta ulin deficitin buxhetor duke promovuar rritjen ekonomike, duke ulur shpenzimet qeveritare apo duke ngritur nivelin e taksave. Politika fiskale në Kosovë është e ndërtuar kryesisht mbi parimin e respektimit të rregullës fiskale, e cila kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të brutoprodhimit vendor, që ka filluar të implementohet për herë të parë në buxhetin e vitit 2014. Si rezultat i kësaj, deficitin e përgjithshëm buxhetor ka rënë nga 3.1% e prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2013 në 2.2% në vitin 2014. (Alban Zogaj)

DEFLACIONI. Rënie e përgjithshme e çmimeve në vend, e kundërta e inflacionit. Deflacioni zakonisht shkaktohet nga rënia e ofertës së parasë apo kredisë. Deflacioni mund të shkaktohet gjithashtu edhe nga rënia e kërkesës agregate, apo nga rënia e konsumit të përgjithshëm, rënia e shpenzimeve qeveritare apo rënia e investimeve. Mund të shkaktojë rritjen e papunësisë në vend, për shkak se në këtë situatë zvogëlohet kërkesa agregate. Deflacioni zakonisht e përcjell inflacionin, por normalisht është më i shkurtër në kohë dhe me intensitet më të ulët. Kosova ka përjetuar deflacion në vitet 2007-2008, kur kishte rënie të çmimeve për 2-3%. Konsiderohet se deflacioni i asaj kohe ishte rezultat i rënies së kërkesës agregate në vend, që erdh si rezultat i një mori faktorësh, duke filluar nga kriza financiare botërore, rënia e konsumit agregat, por edhe nga shpenzimet e ulëta publike. (Alban Zogaj)

DEFTERËT E REGJISTRIMIT TË SANXHAQEVE TË KOSOVËS. Defteri është regjistër zyrtar i administratës së Perandorisë Osmane. Ekzistojnë më shumë se 100 defterë të shek. XV dhe XVI, të llojeve të ndryshme të administratës osmane që janë hartuar së pari nëpër qendrat e vilajeteve dhe sanxhaqeve të Rumelisë, më vonë në ato të Kosovës, të formuara si njësi administrative-territoriale të Perandorisë Osmane. Më të rëndësishmit që

kanë të bëjnë me regjistrimin e tokave shqiptare të Kosovës mesjetare janë regjistrat kadastrale osmanë të quajtur “Tapu tahrir defterleri”. Defterët osmanë sjellin të dhëna me vlerë historike për sistemin administrativ të sistemit të timarit feudal e ushtarak osman, për gjendjen sociale, ekonomike, demografike, strukturën fetare dhe etnike të popullsisë. Defterët po ashtu sjellin të dhëna dhe elemente të tjera, me vlerë onomastike e linguistike. Defteri më i vjetër për tokat shqiptare, tashmë i njohur në historiografinë shqiptare, është “Defteri i Sanxhakut të Arbërisë mesjetare” (Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid) i vitit 1431/32, i cili përfshinte një pjesë të Arbërisë Qendrore dhe Jugore, por jo edhe pjesën verilindore të tij. Kurse defteri më i vjetër deri më tani që është gjetur dhe që përfshin edhe disa pjesë të territorit të Kosovës mesjetare, që janë regjistruar në kuadër të defterëve të Rumelisë, është Defteri i Rumelisë i vitit 1451/52. Defteri tjetër i llojit të timarit i vitit 1544 përfshin pothuajse të njëjtat vendbanime të Kosovës, (me përjashtim të vilajetit Arvanit, gjegjësisht të vilajetit të Bistricës). Defteri që ka përfshirë regjistrimin e pjesës më të madhe të Rrafshit të Kosovës Qendrore, është defteri i hollësishëm i vilajetit Vëlk (Defter-i Mufassal-i vilajet-i Vëlk nr.2m) i vitit 1455. Në defterin sumar të timareve nr.16 të vitit 1477, Rrafshi i Kosovës ishte regjistruar në kuadër të haseve të Sinan Beut, sanxhakbej i sanxhakut të Vuçitërnës, po ashtu me orgjinë shqiptare. Në defterin tjetër, sumar nr. 22 të vitit 1478 Rrafshi i Kosovës ishte regjistruar përsëri, por tani si has i Mehmet Beut, të birit e Hurem Beut, sanxhakbej i sanxhakut të Vuçitërnës. Në defterin e hollësishëm të fundshekullit XV, të vitit 903H/1497/98 (Tapu Tahrir Maliye Defteri-nr.28), ishte regjistruar territori i kazasë së Novobërdës, si njësi e posaçme administrative-territoriale, me qytetin e Novobërdës, me 38 lagje dhe 210 fshatra, që përfshiheshin në haset e sulltanit. Në defterin e hollësishëm të vitit 1569/70 (Defter-i Mufassal-i Liva-i Vllçiterrin-nr.124), në të cilin ishte regjistruar sanxhaku i Vuçitërnës, tani përfshinte një territor shumë më të gjerë të Kosovës, me 25 nahije dhe 1,093 fshatra, por pa nahijen e Kaçanikut dhe pa Kosovën Perëndimore, përkatësisht Rrafshin e Dukagjinit, i cili sundohej nga Balshajt dhe Dukagjinasi, territor që, me vendosjen e administratës osmane ka qenë i regjistruar në

defterët e sanxhaqeve të Prizrenit, të Dukagjinit dhe të Shkodrës. Në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 (Defter-i Mufassal -i Liva-i Iskenderiyye-nr. 17) është regjistruar kazaja e Pejës, nahija Altun-ili (Juniku) me Gjakovën, si edhe nahija e Suhagërlës me Istogun. Edhe në defterin tjetër të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582 (nr. 59) janë regjistruar të njëjtat nahije të Kosovës. Defterët më të vjetër që janë gjetur për sanxhakun e Prizrenit janë: defteri sumar i timarit i vitit 1477 (Defter-i icmal- nr.5m), i pjesshëm, 61 faqe, i pabotuar; defteri sumar i timarit i vitit 1518 (Defter-i icmal-nr. 92); dhe defteri i hollësishëm i sanxhakut të Prizrenit i viti 1530 (Defter-i Mufassal-i Liva-i Przerin-nr. 368). Në defterët e sanxhakut të Dukagjinit të viteve 1571, (nr. 499. dhe 1591, nr. 63), janë regjistruar disa pjesë të Kosovës Perëndimore. Pjesa më e madhe e defterëve që përfshijnë sanxhaqet e Kosovës kanë mbetur të pabotuar. (Iljaz Rexha)

DEGËT E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT. Struktura të organizuara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP), të cilat u morën me qeverisjen lokale dhe organizimin e mbrojtjes. Sipas rregulloreve të para të miratuara në Kuvendin e Përgjithshëm, që kishin forcën e dekretligjeve, Prizreni ishte selia e LSHP-së. Organi i saj kryesor ekzekutiv ishte Komiteti Qendror (KQ), nga i cili vareshin komitetet e sanxhaqeve dhe nga këto vareshin degët e Lidhjes, të cilat u formuan dhe do të formoheshin në kazatë e vilajeteve. Populli zgjidhte anëtarët e komiteteve të sanxhaqeve dhe të degëve të kazave të tyre, ndërsa anëtarët e KQ të LSHP-së zgjidheshin nga një për çdo sanxhak. Anëtarët e degëve zgjidheshin nga banorët e qyteteve dhe të fshatrave të mëdha. Të gjitha komitetet e degëve vepronin sipas vendimeve të KQ në Prizren. Korrespondencat e degëve me KQ duhej të kishin vullat e anëtarëve të komitetit të degës përkatëse. Pas shpërndarjes së delegatëve të Kuvendit të Përgjithshëm, në të cilin u themelua LSHP-ja, në Prizren qëndruan vetëm anëtarët e KQ për të ndjekur dhe koordinuar punët e përditshme. Të tjerët formuan në vendet e tyre degët, të cilat zbatonin të gjitha urdhrat që merrnin nga Prizreni, si dhe merreshin me organizimin e forcave të armatosura lokale, sipas urdhrat të qendrës në Prizren, aty ku do të paraqitej nevoja. Në qoftë se armiku do të sulmonte ndonjë pjesë

të Shqipërisë, atëherë fiset më të afërme kishin për detyrë të mblidhnin forcat e armatosura, sipas zakonit, dhe të bashkoheshin me krahinat e tjera, posa të shpallej kushtrimi nga Prizreni. Komandanti i përgjithshëm për ushtrinë e çdo krahine dhe të gjithë oficerët e tjerë zgjidheshin nga banorët vendës, kurse këshillat qeveritare të degëve kishin të drejtë të kontrollonin numrin e ushtarëve, ndërsa oficerët nuk kishin të drejtë ta kundërshtonin këtë veprimtari. Dekretligjet e përmendura përcaktonte detyra dhe dënime për qytetarët ushtarë, për krerët vendorë, për administratorët dhe për oficerët, sipas kërkesave të LSHP-së, që përcaktonte vëllimin e njësiteve ushtarake (kompanive, batalioneve), gradat e oficerëve etj. Dega e LSHP-së kishte obligim që forcat vullnetare t'i sistemonte si ushtrinë e rregullt. Degët e Lidhjes kishin të drejtë, në bazë të nevojave konkrete të brendshme, të mobilizonin aq ushtarë sa të kërkonin banorët vendës. Nga ana tjetër, degët duhej t'i përgatisnin kuajt dhe materialin tjetër të luftës që do t'i nevojiteshin ushtrisë. Degët duhej të tregonin saktësisht sa burra janë të aftë për luftë në territorin e tyre. Degët zhvillonin edhe veprimtari të tjera ndihmëse, që kishin për qëllim realizimin e programit të LSHP-së, por kishin edhe autonomi veprimi. Degët e Lidhjes dërgonin kërkesa, protesta, memorandum e akte të tjera në adresë të Kongresit të Berlinit, të Fuqive të Mëdha, të Stambollit etj. Dega e LSHP-së në Shkodër themeloi shoqërinë muzikore, e cila kompozoi himnin e Lidhjes-Marshin e Lidhjes, me të cilin vullnetarët niseshin në luftë. Dega e Janinës nuk e pranonte kufirin me Greqinë. Në Kuvendin e degës së LSHP-së të Prevezës (28 janar 1879) morën pjesë delegatët e degëve nga Shkodra, Durrësi, Elbasani, Ulqini, Prizreni, Dibra dhe Pazari i Ri. (Masar Rizvanolli)

DEHARI Avni (1947-). Gazetar. Lindi në Sllupçan të Kumanovës, ku mbaroi arsimin fillor, ndërsa gjimnazin e kreu në Preshevë. U diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi mësimdhënës në gjimnazin e Kumanovës, pastaj, si ish-i përndjekur politik, u zhvendos në Bernë të Zvicrës dhe u zgjodh anëtar i Kryesisë së Lëvizjes për Republikën e Kosovës (LPRK) (1987-1991). Ishte anëtar i redaksisë së gazetës "Zëri i Kosovës" (1985) dhe kryeredaktor i saj (1991-1992). Pas çlirimit

(1999) u kthye në Prishtinë dhe një kohë punoi redaktor i lajmeve në Radion “Kosova e lirë” (2000-2001). Në vitin 2007 për disa muaj ushtroi detyrën e redaktorit të kulturës në gazetën “Lajm” të Prishtinës. Botoi disa libra për të rritur dhe për fëmijë (“Hëna në dritare”, “Kënga e drerit fjalëpak”, “Flokëhapreshuri”, “Gjergji i Arbërisë” etj). (Muhamet Mavraj)

DEHARI Fatmir (1974-). Aktivist politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare në Maqedoni. Lindi në fshatin Serbicë të Kërçovës. Shkollën e mesme e kreu në Elbasan, ndërsa studimet në Universitetin e Prishtinës. Punoi si mësimitdhënës në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, më pas asistent në Universitetin e Prishtinës dhe të Tetovës. Me fillimin e luftës në Maqedoni i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, si oficer i lartë në Shtabin e Përgjithshëm. Pas përfundimit të luftës u bë pjesë e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Në periudhën 2002-2006 kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e Maqedonisë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009 u zgjodh kryetar i komunës së Oslomesë, ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2013 u zgjodh kryetar i komunës së Kërçovës. (Fehari Ramadani)

DEHIRI Ismet (1928-1993). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Gjakovë. Punoi mësues në fshatin Shajne të Dragashit. Studimet i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1952). Ishte ndër profesorët e parë shqiptarë të matematikës. Punoi në Gjimnazin e Prishtinës, në atë të Pejës dhe në Shkollën Normale të Prizrenit (1952-1962). Ligjëroi disa kurse në Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) “Xhevdet Doda” në Prizren (1962-1970). Në vitin 1970 zgjidhet ligjërues i lartë në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1970). Mbrojtiti tezën e disertacionit në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1977. Në vitin 1982 zgjidhet profesor ordinar në FSHMN të UP-së. Ligjëroi edhe në SHLP të Gjakovës dhe në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik në Mitrovicë. Kreu edhe detyra me rëndësi në institucionet e arsimit. Ishte autor i një monografie për matematikë dhe i dy teksteve universitare (“Matematika” I, II,

“Aritmetika me fillimet e algjebërës”). Botoi një numër punimesh shkencore e profesionale në revista të vendit. (Minir Efendija)

DEINDUSTRIALIZIMI. Zvogëlimi kontributit të sektorëve industrialë në krijimin e vlerës së re në një vend. Ky fenomen karakterizon ecuritë në ekonominë e Kosovës pas vitit 1989 e deri në vitin 2000. Brenda kësaj periudhe pjesëmarrja e industrisë në krijimin e brutoprodhimit vendor ka rënë nga rreth 45% në më pak se 15%. Rënia e madhe e prodhimit industrial në Kosovë gjatë viteve ‘90 të shekullit të kaluar erdhi si pasojë e administrimit të dhunshëm të ndërmarrjeve industriale nga regjimi serb dhe nga mungesa e investimeve në industri, dukuri që vazhdoi edhe në vitet në vijim. Deindustrializimi vazhdoi edhe për shkak të vonësës së privatizimit të ndërmarrjeve industriale në pronësi shoqërore dhe dështimeve që shumë ndërmarrje të privatizuara të ringjallin aktivitetin e tyre prodhues pas privatizimit. Kjo situatë u përcoll me efekte negative në krijimin e vendeve të punës, me mundësitë e vogla eksportuese dhe me rritjen e deficitit në bilancin tregtar të vendit. Si rezultat, deindustrializimi në Kosovë është përcjellë me rritjen e papunësisë dhe ashpërsimin e problemeve social-ekonomike. Prandaj, një nga drejtimet e politikave ekonomike dhe zhvillimore në Kosovë sugjerohet shpesh riindustrializimi si proces që ndihmon të tejkalohen problemet e përmendura. Një riindustrializim i lehtë në Kosovë ka filluar të ndodhë 4-5 vitet e fundit, me ngritjen e ngadalshme të prodhimit në sektorët e përpunimit të ushqimit dhe të pijeve, të materialit ndërtimor, në industrinë e drurit etj. (Muhamet Mustafa)

DEKANATET E KISHËS KATOLIKE NË KOSOVË. Dekanatet e Kishës Katolike janë nënndarje administrative të një dioqeze, entitete, brenda të cilit mund të bashkohen disa famulli fqinje, me objektiv kryesor promovimin e kujdesit baritor përmes veprimit të përbashkët. Në historinë e kishës dekanati nënkuptonte bashkimin e dhjetë famullive, ndërsa sot ky numër mund të jetë i ndryshëm. Çdo dekanat drejtohet nga një dekan prift, i cili emërohet nga ipeshkvi.

Ipeshkvia e Kosovës është e ndarë në katër dekanate: Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Dekanati i Prishtinës, që si territor shtrihet në

Rrafshin e Kosovës, ka nëntë famulli dhe pesë filiale. Në kuadër të këtij dekanati veprojnë edhe dy qendra sociale-edukative, “Don Bosko” në Prishtinë dhe Gjilan, rezidenca ipeshkvnore dhe Katedralja “Nënë Tereza” në Prishtinë etj. Dekan është dom Rrok Gjonlleshaj. Dekanati i Pejës ka tetë famulli dhe dymbëdhjetë filiale me dekan dom Lenc Sopin. Dekanati i Gjakovës, me dekan dom Tomë Karricën, ka gjashtë famulli dhe pesëmbëdhjetë filiale. Ka edhe Qendrën për arsim dhe këshillim profesional “Gjon Nikollë Kazazi” në Gjakovë, si edhe shenjtëroren e Shën Antonit (Ndout). Dekanati i Prizrenit, me dekan dom Shën Zefin, ka tri famulli dhe katër filiale, si edhe gjimnazin “Loyola”. (Sarë Gjergji)

DEKLARATA E G-8 PËR KOSOVËN (6 maj 1999). Deklaratë e shtatë vendeve më të industrializuara të botës, plus Ruisë (G-8), për zgjidhjen e krizës së Kosovës. Takimi i G-8-ës u mbajt më 6 maj 1999 në Petersberg afër Bonit në Gjermani, në të cilin morën pjesë Gjermania, Franca, Britania e Madhe, SHBA-ja, Japonia, Kanada, Italia dhe Rusia. Ky takim u mbajt derisa NATO-ja vazhdonte sulmet ajrore kundër objektivave ushtarake të Jugosllavisë së mbetur. Në këtë fazë të zhvillimit të krizës së Kosovës, të gjitha përpjekjet e Perëndimit ishin përqendruar te përfshirja e Ruisë në anën e Perëndimit, në mënyrë që Beogradi të mbetej i izoluar. Për ta arritur këtë, të gjitha përpjekjet diplomatike të Gjermanisë (që ishte kryesuese e radhës e BE-së dhe e G-8) dhe shteteve të tjera anëtare të NATO-s u intensifikuan në organizimin e një takimi të ministrave të jashtëm të shteteve anëtare të Grupit G-8. Negociatat përfunduan me arritjen e pajtimit për miratimin e parimeve të përgjithshme për zgjidhjen politike të krizës së Kosovës, të cilat do të dërgoheshin në OKB për autorizim. Këto parime më vonë do të përbëjnë thelbin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila siguroi ndërprerjen e luftës dhe vendosjen e administrimit civil ndërkombëtar në Kosovë. (Sylë Ukshini)

DEKLARATA KUSHTETUESE E 2 KORRIKUT (1990). Dokument themelor burimor i vetëpërcaktimit të popullit shumicë të Kosovës, i miratuar dhe i shpallur nga delegatët e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës më 2 korrik 1990. Deklarata ishte

përgjigje institucionale e Kosovës ndaj akteve të Serbisë, që rrënuan autonominë në vitin 1989 dhe njëkohësisht shprehje e vullnetit të popullit shqiptar për Kosovën e pavarur. Deklaratën Kushtetuese e miratuan 111 delegatë të Kuvendit të KSA të Kosovës në Prishtinë më 2 korrik 1990, me përcaktimin për Kosovën njësi e pavarur dhe e barabartë në Federatën apo Konfederatën e Jugosllavisë. Deklarata ishte një akt i vetëvendosjes demokratike dhe një akt historik. Rëndësia e veçantë e Deklaratës Kushtetuese qëndronte te kërkesa e saj për anulimin e vendimit të “dhënies së pëlqimit” në Amendamentet e Kushtetutës së Serbisë më 23 mars të vitit 1989, sepse ky “pëlqim” as që ekzistonte në procesverbalin e seancës së Kuvendit të Kosovës, kur ishte suprimuar me dhunë autonomia e Kosovës. Përveç kësaj, Deklarata Kushtetuese shpalli Kosovën si njësi të mëvetësishme dhe të barabartë në kuadrin e një federate ose konfederate të Jugosllavisë. Deklarata nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën atëherë në fuqi të ish-Jugosllavisë, por përmbante kërkesën për rregullimin kushtetues me një pozitë të re kushtetuese të deklaruar nga Kuvendi legal dhe legjitim i Kosovës. Delegatët e Kuvendit të Kosovës, përmes Deklaratës Kushtetuese, përcollën vullnetin e popullit të Kosovës se në kohën e ripërkufizimit të ish-RSFJ-së, Kosova nuk mund të përjashtohet dhe se Kosova, pas 2 korrikut 1990, do të vendoste vetë për statusin e saj politik, varësisht nga zhvillimet në ish-Jugosllavi. Deklarata Kushtetuese vuri themelet e rrugëtimit të Kosovës drejt pavarësisht, duke u përcjellë me aktet e tjera politike e kushtetuese të dekadës së fundit të shekullit XX. E njëjta përbërje e delegatëve të Kuvendit të KSA të Kosovës, dy muaj më vonë, më 7 shtator 1990, në Kaçanik aprovoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut. (Esat Stavileci)

DEKORIMET PLASTIKE (sh. III-XX). Janë realizime artistike në gurë dhe material tjetër në objektet fetare dhe laike në Kosovë. Paraqiten në të gjitha periudhat, që nga ajo parahistorike, antike pararomake, gjatë sundimit romak, bizantin dhe osman. Këto dekorime gjenden në objekte fetare, qofshin pagane, të krishtere apo islame, por gjenden edhe në ndërtime civile, përfshirë edhe arkitekturën e banimit popullor. Dekorimet plastike u realizuan në teknikën e relievit të imët, por ka raste edhe të relievit të

mesëm dhe të plotë. Këto vepra të artit i gjejmë në kapitelet e shtyllëzave, të shtyllave, të portaleve ose para portaleve, në dritare, në ikonostase të gurit, në disa pjesë të minareve, në mihrab, në mimber dhe mahfil, në pjesë ballore dhe harkore të urave, mbi dritare të odës së burrave etj. Janë dekorime figurative dhe aplikative të periudhave të ndryshme, që nga antikiteti e deri në dekadat e para të shek. XX. Ndër motivet figurative dhe ornamentale gjenden figura, si: gjarpërinj, luanë, pëllumba, rozeta me motivet e diellit, të Ylli të Davidit etj. Disa nga këto motive paraqiten edhe në objekte të stilit romanik ose roman-gotik. Dekorimet ornamentale janë të pranishme edhe në objektet e periudhës osmane. Motivët e antikitetit paraqiten edhe në ndërtimet më të vona, në disa objekte të banimit të fshatit apo të qytetit, në kulla në veçanti. Dekorimet plastike qofshin figurative apo ornamentike, që shfaqen në objekte fetare e civile, pavarësisht nga koha e realizimit të tyre, flasin për vlerat artistike dhe mjeshtrorë të objekteve të ndërtimeve në territorin e Kosovës. (Fejaz Drançolli)

DELHYSA-LEKAJ Hermina (1944-2007).

Mezosoprano. Shkollën e muzikës e kreu në Prizren, në drejtimin e solokëndimit. Gjatë atyre viteve, si nxënëse, ishte aktive në korin



HERMINA
DELHYSA-LEKAJ

e Shoqërisë kulturore-artistike "Agimi" dhe paraqitej me arie e këngë solo (romanca), e shoqëruar me piano nga pedagogia e saj e solokëndimit, Desanka Tokin. Më pas u pranua në Akademinë e Muzikës në Beograd, në degën e solokëndimit, ku gjithashtu paraqitej në koncerte interne dhe publike të organizuara nga Akademia. Pas diplomimit u kthye në Kosovë për të vazhduar aktivitetin e saj prej mezosopranoje në koncerte e festivale, realizuar nga Radiotelevizioni i Prishtinës, Kori "Collegium Cantorum", Shoqata e Kompozitorëve e Kosovës dhe në festivale e koncerte në Kosovë dhe më gjerë. Mori pjesë në Tribunën Muzikore Jugollave në Opati (Kroaci) me vepra të autorëve tanë dhe të huaj. Ishte pedagoge për zë dhe këndim në degën e dramës në Fakultetin e Arteve. (Besa Luzha)

DELIA Ahmet (1850-1913). Veprimtar i lëvizjes së armatosur për çlirim kombëtar. Lindi në Prekaz të Epërm të Skënderajt. Mori pjesë në mbrojtjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Lidhjes Shqiptare të Pejës. Gjithashtu mori pjesë në djegien e Sarajit të Kajmekamit më 1891. Më 1903 udhëhoqi Kuvendin e Drenicës në Morinë të Skënderajt. Në vitin 1908 u kap rob nga ushtria turke dhe u dërgua në Izmir të Turqisë. Më pas u përfshi në kryengritjen e përgjithshme shqiptare të vitit 1912. Në dhjetor të atij viti një ekspeditë ushtarake serbe mësyu Prekazin e Epërm, duke plaçkitur fshatin. A.Delia, bashkë me të birin Murselin dhe me bashkëfshatarë të tjerë, iu kundërvunë ushtarëve serbë. Në këtë përleshje, që rezultoi me vrasjen e krejt njësitit të ushtrisë serbe, u vra edhe A. Delia. (Liman Rushiti).

DELIA Mehmet (1898-1946). Luftëtar në çetat nacionalçlirimtare kaçake në Kosovë, që nga viti 1916. Në popull ishte i njohur si Mehmeti i Vogël. Ishte bashkëpunëtor i Azem e Shotë Galicës. Në vitet 1923/24 mori pjesë në anën e lëvizjes demokratike në Shqipëri, në krah të Bajram Currit e Fan Nolit. Pas vrasjes së Azem Galicës, iu bashkëngjit çetës së Shotë Galicës. Më 1926, me çetën e Shotës mori pjesë në betejën në fshatin Llaush të Skënderajt, ku u zhvillua edhe beteja e fundit e Shotës në Kosovë. Pas kësaj kohe u vendos në shtetin shqiptar, ku hyri në ushtri, për shkak të përvojës luftarake. Shërbeu si oficer karriere, kryesisht në kufirin greko-shqiptar. Gjatë luftës ndërmjet Italisë dhe Greqisë nuk i zbatoi urdhrat e italianëve. Me ide ishte antifashist, prandaj në nëntor 1942 italianët e arrestuan dhe e dërguan në burgun e Barit në Itali. Aty edhe vdiq në një sanatorium më 1946. (Liman Rushiti).

DELIA Mursel (1881-1931). Lindi në Prekaz të Epërm të Skënderajt. Ishte biri i Ahmet Delisë. Më 1912, bashkë me të atin, mori pjesë në qëndresën e armatosur kundër pushtimit serb. Ishte njëri ndër bashkëluftëtarët e Azem Galicës. Nga amnistia e shpallur për kaçakët (1921) përfitoi edhe M. Delia, por vetëm pas tre muajve iu bashkëngjit sërish çetave çlirimtare, deri në vrasjen e Azem Galicës në verë të vitit 1924. Nga jeta e gjatë në male ai u sëmur rëndë dhe lëngoi disa vjet me radhë. Më 1931 u dërgua në spitalin e Shkupit, por atje supozohet se u helmua dhe vdiq disa muaj më vonë. U varros në varrezat e Butelit në Shkup. (Liman Rushiti).

DELJA. (*Ovis aries*) Janë kafshë shtëpiake të imëta, të cilat për ushqim shfrytëzojnë një numër të madh bimësh nga livadhet dhe kullotat, që kafshët e tjera i përdorin me vështirësi ose nuk mund t'i shfrytëzojnë fare. Delet janë kafshë ripërtpëse, që kanë aftësi që materiet ushqyese nga ushqimet voluminoze t'i shndërrojnë në prodhime me vlerë të lartë ushqyese, siç është qumështi, mishi dhe prodhimet e tjera (leshi, lëkura dhe plehu). Sektori i dhenve në Kosovë paraqet degë të rëndësishme të blegtorisë, me traditë shumë të hershme. Dekadave të fundit numri i deleve në Kosovë është zvogëluar ndjeshëm. Një mori ngjarjesh kanë ndikuar në rënien e numrit nga 600,000 krerë sa kishte në vitet '60, në mbi 420,000 krerë në vitet '80, e deri në 129,432 krerë, sa është numri aktual i tyre në Kosovë. Në rënien e numrit të deleve, përveç luftës së fundit, ka ndikuar edhe humbja e tregjeve për shitjen e prodhimeve, siç është mishi i qengjit dhe lesi. (Ragip Kastrati)

DEMA Marjan (1957-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Stupe të Klinës. Shkollën fillore e kreu në Budisalc, kurse gjimnazin matematikor në Prishtinë. Studimet për



MARJAN DEMA

matematikë i kreu në vitin 1980 në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP), ku edhe magjistroi (1984). Qëndroi për specializim në Universitetin Shtetëror në Vilnius, Lituani (1983/84). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1987). Puna e tij shkencore i takon kryesisht fushës së interpolimit në hapësirat H^p . Ka botuar disa punime shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit. Ka kryer edhe disa funksione në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe detyrën e rektorit të Universitetit të Prishtinës. (Qamil Haxhibeqiri)

DEMAÇI Adem (1936-). Veprimtar politik, shkrimtar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin parauniversitar. Studimet për letërsi i filloi në Universitetin e Beogradit, por i ndërpreu për shkak të burgosjes nga regjimi jugosllav. Që atëherë iu përkushtua çështjes



ADEM DEMAÇI

kombëtare, për çka vuajti dënimin me burg prej 28 vjetësh në burgjet jugosllave, duke u quajtur "Mandela i Europës". Që në vitet '50 të shekullit të kaluar botoi krijimet e para letrare, si një nga autorët e parë të prozës në Kosovës.

Burgosja e ndërpreu krijimtarinë e nisur letrare me "Gjarpërinjtë e gjakut" (1958). Rikthimin në krijimtarinë letrare do ta bëjë në fund të viteve '90, pas daljes nga burgu, duke e zgjeruar opusin letrar me vepra të tjera, si përmbledhje tregimesh, romane, poezi dhe drama: ("Fërkime", "Libër për Vet Mohimin", "Heli e Mimoza", "Nëna Shegë e Pesë Gocat", "Dashuria Kuantike e Filanit", "Alb Prometeu", "Politika dhe pushka", "Tung vargu im" etj.). Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës në vitin 2012 e botoi veprën e përmbledhur të A. Demaçit në 10 vëllime, ndërkaq Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës në vitin 2012 botoi në tri vëllime monografinë për jetën dhe veprimtarinë e tij atdhetare.

Pas botimit të romanit "Gjarpijtë e gjakut", A. Demaçi u bë i njohur ndër lexuesit e Kosovës, por në të njëjtën kohë filloi të ndiqej edhe nga organet e sigurimin shtetëror jugosllav. Në verën e 1958 iu sugjerua që të inkuadrohej në radhët e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, gjë që ai e refuzoi. Në nëntor të vitit 1958, në Prishtinë, u arrestua, ndërkaq në gjykimin e parë u dënua me 5 vjet burg për "propagandë armiqësore". Pas daljes nga burgu, nga pranvera e vitit 1963, vazhdoi aktivitetin ilegal me bashkëmendimtarët e tij, për formimin e "Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve". Në qershor të vitit 1964 u arrestua sërish, si prijës i grupit që ishte dënua nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet burg. Dënimin e dytë e kreu në qershor të vitit 1974. Ndërkohë, gjendja në Kosovë kishte ndryshuar dukshëm, por lëvizja politike për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi dhe të statusit kushtetues të Kosovës nuk kishin reshtur. Në anën tjetër, represioni shtetëror mbi shqiptarët nuk ishte ndalur. Kështu, gjatë vitit 1975 në Kosovë u bënë burgosje dhe u zhvilluan shumë procese të montuara gjyqësore. Më 6 tetor 1975, A. Demaçi u burgos në Prishtinë për herë të tretë. Në procesin e kurdisur, pas

hetimeve të dhunshme, A. Demaçi me grupin e tij u dënua prej 5 deri në 15 vjet burg. Pas kësaj burgosjeje dhe dënimit të tretë, u lirua më 21 prill 1990.

Pas daljes nga burgu, A. Demaçi u përfshi në zhvillimet politike të kohës. Në periudhën 1990-1995 udhëhoqi Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Në vitin 1991 u nderua nga Parlamenti Europian me Çmimin "Saharov", çmim prestigjioz, me të cilin qenë nderuar personalitete të njohura botërore. Në këtë periudhë, A. Demaçi i bashkohet Partisë Parlamentare të Kosovës, me qëllim të krijimit të "Forumit Demokratik të Kosovës". Në vitet e fundit të shekullit XX doli me modelin e "Ballkanisë", si një integrim rajonal, por ideja nuk u përkrah as në Kosovë dhe as në Serbi. Pas shpërthimit të konflikteve të para në Kosovë, në pranverë të 1996, realizoi një fushatë lobuese në Bruksel, Hagë dhe Londër për t'i bindur fuqitë europiane që ta pengonin gjakderdhjen në Kosovë. Me shpërthimin e luftës çlirimtare, më 5 dhjetor 1997 iu drejtua me një letër të hapur UÇK-së, ndërkaq më 22 shkurt 1998, në Qendrën Amerikane në Prishtinë kundërshtoi të dërguarin special të SHBA-së për ish-Jugosllavinë, z. Gelbard dhe tezën e tij për "UÇK-në si organizatë terroriste". Më 12 gusht 1998 në një takim me udhëheqjen e UÇK-së në Tiranë, u arrit marrëveshja që A. Demaçi të bëhej udhëheqës politik i UÇK-së. Në vitet 1998-1999 ai ishte zëdhënës politik i UÇK-së në Prishtinë, post që e ushtroi deri më 26 shkurt 1999, kur dha dorëheqje, meqë nuk u pajtua me Marrëveshjen e Rambujesë, me arsyetimin se me këtë marrëveshje Kosova mbetej nën Serbi.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë A. Demaçi nuk u anëtarësua në asnjë parti politike dhe nuk ushtroi ndonjë funksion shtetëror, por vazhdoi të ishte aktiv në jetën publike. Funksioni i tij i fundit publik ishte pozita e kryetarit të bordit të drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), që e ushtroi nga viti 2001 deri më 2003. (Blerim Reka)

DEMAJ Adem (1950-). Agronom, profesor universitar. Lindi në Vitomiricë të Pejës. Kreu Shkollën e Mesme Bujqësore në Pejë, studimet e rregullta dhe studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit, në Zemun. Tezën e disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë

të Universitetit të Prishtinës (1995). U zgjodh asistent në Fakultetin e Bujqësisë (1979) dhe në vijim i mori të gjithë titujt universitarë. Ligjërroi lëndën mbrojtja e ambientit të njeriut dhe disa lëndë të tjera. Botoi punime shkencore dhe profesionale dhe udhëhoqi disa projekte shkencore. (Latif Susuri)

DEMAJ Frashër (1973-). Historian, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës. Lindi në Radac të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa




FRASHËR DEMAJ

gjimnazin në Pejë. Studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1996). Po aty kreu studimet pasuniversitare, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Punoi në disa shkolla fillore dhe të mesme të Prishtinës. Nga viti 2003 punon në Institutin e Historisë në Prishtinë ku ishte sekretar shkencor dhe ushtrues i detyrës së drejtorit të Institutit. Është autor i disa botimeve të veçanta dhe në bashkautorësi: "Afrim Xhuraj, jeta dhe vepra" (2009), "Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913" (2011), "Mulla Zekë Bërdynaj, intelektual, atdhetar e prijës fetar" (2016). Është përfshirë si bashkautor në disa botime të përbashkëta për mësim plotësues të historisë së rajonit (Cetinë 2012 dhe Selanik 2016), si projekte të Bashkimit Europian. Është autor i teksteve shkollore me fletore pune për shkolla fillore dhe të mesme. (Isa Bicaj)

DEMAJ Hajrush (1945-2015). Skiator, trajner, punëtor sportiv. Lindi në Bogë të Rugovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Pejë. Fakultetin e Kulturës Fizike e mbaroi në Prishtinë. Me skitari filloi të merret që nga fëmijëria, ndërsa mori pjesë në gara të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ishte kampion i shumëfishtë i Kosovës në skitari, ndërsa si anëtar i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë në skijim ka bërë gara në Austri, Rumani, Bullgari, Slloveni, Bosnjë, Turqi etj. Pesë herë është zgjedhur në mesin e dhjetë sportistëve më të mirë të Kosovës. Në periudhën 1975-2000 ishte përzgjedhës

i përfaqësueses së Kosovës në skitari. Ishte trajner i lartë i skijimit alpin dhe skijimit mbi bar, si dhe gjyqtar ndërkombëtar. Ishte kryetar i Federatës Skitare të Kosovës. (Bekim Aliu)

DEMAKU Daut (1944-). Shkrimtar. Lindi në Abri të Epërme të Skënderajt. Shkollimin e filloi në vendlindje, ndërsa e vazhdoi në Prishtinë. Ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve “Bota



DAUT DEMAKU

faqësues i kësaj fryme të mendimit në Kosovë. Veprat kryesore: “Brigjet e thata” (1967), “Plisat e kuq” (1969), “Shi e puhi” (1979), “Bletaja” (1976), “Mote të thata” (1983), “Trëndafila pa gjemba” (1986), “Tregime shqiptare” (1996), “Mendimi dhe suksesi” (1997), “Magjia e urtisë” (2000), “Shenjat para kthesave” (2002), “Thuaji jetës mirëmëngjes” (2003), “Rina dhe gjyshi” (2004), “Aforizma” (2005); pjesët teatrale: “Trenat e mesnatës” (1972), “Shelgjishtja është dëshmitare” (1978), “Ndryshoje veten o njeri” (2004), “Servisi i shpirtit” (1997), “Ulërima” (2004). Viteve të fundit ai bëri emër si promovues kryesor i shkollës së mendimit pozitiv në Kosovë. (Kujtim Rrahmani)

DEMAKU Jahir (1971-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Abri të komunës së Drenasit. Kontaktet e para me UÇK-në i mori në vitin 1995. Më 1998 u emërua komandant i njësiteve “Guri”, më pas komandant i Brigadës 111 “Adem Jashari”. Mori pjesë në shumë beteja të zhvilluara në anën e Drenicës, si në grykën e Llapushnikut, në betejat në Likoc, Morinë dhe Rezallë. Po ashtu ishte pjesëmarrës edhe në luftimet që u zhvilluan kundër forcave serbe, të cilat bënë përpjekje që të depërtonin në Likoc (12-22 shtator 1998) dhe në betejën e 7 prillit 1999, që ishte një ndër betejat më të mëdha të UÇK-së. Pas përfundimit të luftës mori detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Haxhi Ademi)

DEMAKU Xhevat (1974-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Abri të Epërme të komunës së Drenasit. Ishte pjesëmarrës i njësitit gueril luftarak “Guri”, kur mori pjesë në zënien e grykës së Llapushnikut (9 maj 1998). Mori pjesë edhe në luftimet e zhvilluara në grykën e Llapushnikut, edhe me rastin e ofensivës serbe (korrik 1998). Ishte pjesëmarrës edhe në luftimet që u zhvilluan në vijën e frontit Marinë-Rezallë-Likoc (gusht 1998), si dhe në luftimet në Likoc (shtator 1998). Pas ristrukturimit të UÇK-së, u caktua në Brigadën 111 “Adem Jashari”. Ishte pjesëmarrës i sulmit mbi stacionin policor të Drenasit (10 nëntor 1998), pastaj mori pjesë në shumë luftime të zhvilluara në Zonën Operative të Drenicës (janar-mars 1999), në sulmin kundër forcave serbe në fshatrat Kryshec, Plloçicë etj. Ra dëshmor në luftimet në hyrje të fshatit Abri e Epërme më 7 prill 1999. (Haxhi Ademi)

DEMALIA Adnan (1962-). Atlet. Lindi në Pejë. Me atletikë filloi të merret që nga viti 1978, në klubin e atletikës “Prokletije” të Pejës, deri në vitin 1980. Ishte kampion i Kosovës dhe nënkampion i ish-Jugosllavisë në disiplinat 400 dhe 800 metra. Mori pjesë në Lojërat Ballkanike në Greqi, si anëtar i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë, në disiplinën 400 metra dhe stafeten 4x400 metra dhe në tregarëshin në Paris në 800 metra. Në vitin 1980 kaloi në klubin e atletikës “Partizani” të Beogradit, ku qëndroi për katër vjet. Ishte pjesëmarrës i shumë garave vendore dhe ndërkombëtare. Në vitin 1984 u kthye në Kosovë, përkatësisht në klubin e atletikës “Elektroekonomia” të Obiliqit. Karrierën e përfundoi në vitin 1988, për shkak të një dëmtimi serioz. (Rifat Gjonbalaj)

DEMI Ali (1971-). Aktor. Lindi në Gjiilan. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje. Kreu studimet për aktrim në Akademinë e Arteve (1997). Është aktor i Teatrit të Gjiilanit që nga viti 1997. Luajti në shfaqjet: “Lavrja e respektueshme”, “Një natë në hotel”, “Miza në vesh”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Dr. Gjilpëra”, “Beselam pse më flijojnë”, “Romeo dhe Zhuljeta”, “Ëndërr apo zhgëndërr”, “Vegullia”, “Darka publike”, “Trokitja”, “Sakati nga Inishmani”, “UN Inspektori”, “Pacienti i dr. Frojdit” etj. Për disa vjet me radhë ka qenë drejtor i Teatrit të Gjiilanit (2009-2016). (Erson Zymeri)

DEMI Zeqir (1949-2010). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Lisockë, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Hogosht, ndërsa gjimnazin në Kamenicë. Studimet për pedagogji i kreu në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1972), ku edhe magjistroi e doktoroi. Ishte mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në shkollën e mesme në Kamenicë, inspektor arsimit në komunë, nëpunës dhe sekretar i Pleqësisë së Arsimit të Kosovës, ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjilanit. Në vitin 2004 u zgjodh mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, ku ishte edhe prodekan. U angazhua edhe në Fakultetin Pedagogjik në Tetovë. Është autor punimesh të botuar në të përkohshmet e Kosovës, si dhe i disa veprave të veçanta: “Roli i Pleqësisë së Arsimit të Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe” (1995, përkthyer edhe në gjuhën angleze), “Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në territorin e sotëm të Anamoravës 1945-50” (1997), “Format edukative të komunikimit në mësim” (2003) etj. (Januz Dervodeli)

DEMIRAJ Bardhyl (1958-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Tiranë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i ka mbaruar në Universitetin e



BARDHYL DEMIRAJ

Tiranës, ku më pas ka kryer edhe studimet pas-universitare. Specializoi në Vjenë (1984-1986) për gjuhësi indoeuropiane, rumanisht dhe gjuhësi ballkanike. Në vitet 1991-1993 punoi në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë dhe një vit më

pas u doktorua në Universitetin e Tiranës me temë për sistemin e numërorëve të shqipes në rrafshin diakronik. Gjatë periudhës 1994-1995 ka bashkëpunuar me Robert Biksin në Leiden të Holandës në projektin kërkimor për Fjalorin indoeuropian. Kreu hulumtime etimologjike në Bon deri në vitin 2000. Më 2001 u zgjodh profesor i gjuhës shqipe në Institutin për Gjuhësi Krahasimtare dhe Indoeuropiane në Universitetin e Munihut. Është autor i monografive dhe i punimeve të ndryshme studimore. Bëri botimin kritik të Fjalorit të Bardhit, shkroi monografi për Kazazin dhe artikuj shkencorë për “Mesharin” e Buzukut dhe

për Kuvendin e Arbënit, për sistemin e numrave në gjuhën shqipe në rrafshin diakronik, për ditët e javës, për etimologjitë e emrave *shqiptar* dhe *shqa*, për zhvillimin e spirantes *s* të shqipes dhe të laringaleve *ie* dhe refleksive të tyre në shqipen, për futurin e tipit do+lidhore etj. Organizoi disa konferenca ndërkombëtare me temë albanistike. Botoi dhe redaktoi vëllime të ndryshme, mes të cilëve veprën e plotë të Martin Camaj. (Bardh Rugova)

DEMIRAJ Shaban (1920-2014). Gjuhëtar, profesor universitar, akademik. Lindi në Vlorë. Kreu medresenë në Tiranë dhe studimet e larta po në Tiranë. Ishte profesor i Universitetit të



SHABAN DEMIRAJ

Tiranës. Ka qenë anëtar i këshillit organizues dhe delegat i Kongresit të Drejtshkrimit (1972), anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 1989 dhe kryetar i saj një mandat (1993-1997), anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1996) Studimet e tij lidhen me historinë e shqipes. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: “Historia e gjuhës së shkruar shqipe” (1970); “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe” (1972); “Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe” (1975); “Morfologjia historike e gjuhës shqipe I” (1973), II (1976), ribotuar në Prishtinë (1980); “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (1986), ribotuar në Prishtinë (1988); një formë më e përmbledhur e saj është botuar gjermanisht nga Akademia e Shkencave e Austrisë (1993), botim i përmbledhur në Tiranë (2002); “Gjuha shqipe dhe historia e saj” (1988), ribotuar në Prishtinë (1989), botuar edhe në italisht nga Universiteti i Kozencës (1997); “Gjuhësi ballkanike”, botuar në shqip e maqedonisht në Shkup (1994) dhe ribotuar në Tiranë më 2004; “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” (1996); “Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe” (1999) dhe një version anglisht i saj “The origin of the Albanians (linguistically investigated)” (2006); “Gjuha shqipe - Probleme dhe disa figura të shquara të saj” (2003); “Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët” (2008) etj. Ka publikuar punime studimore në revista të ndryshme. Ka transkriptuar dhe përshtatur në shqipen e sotme veprën e Gavril Darës

“Kënga e sprasme e Balës” (1994), ribotuar në Prishtinë (2006). Në bashkëpunim me Kristaq Priftin ka hartuar dhe botuar veprën “Kongresi i Manastirit” (1968), ribotuar më 2005. Botoi një monografi jetëshkrimore për Eqrem Çabejn (1990). Po ashtu ka bashkëpunuar në përmbledhjen enciklopedike-gjuhësore “Formimi i Europës gjuhësore” (La formazione dell’Europa Linguistica, Firenze 1993). Ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Prishtinës, të Shkupit, të Kluzhit (1971), të Romës (1985), të Kopenhagenit (1987), të Arhusit (1987), të Vienës (1988, 1993), të Bonit (1993), të Kozencës, të Palermos dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Ka përkthyer veprën e Xhek Londonit (Jack London) “Martin Iden”. (Bardh Rugova)

DEMIRI Qibrje (1957-). Poete, profesoreshë universiteti. Lindi në fshatin Sazli të Ferizajt. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Ferizaj, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Është mësimdhënëse në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Shkruan poezi për fëmijë dhe për të rritur dhe merret edhe me studime letrare. Poezia e saj shquhet për figuracion të pasur dhe tematikë interesante, që vijnë si përpjekje e fëmijëve për ta njohur dhe kuptuar botën dhe fenomenet e saj. Është prezantuar në disa antologji të poeteshave shqiptare dhe në antologji e panorama të poezisë për fëmijë. Një përmbledhje e saj me poezi “Kur bie shi mbi det” është përkthyer në gjuhën suedeze. Veprat e botuara: “Buzëqeshja sështë larg” (1981), “Flurudhë” (1985), “Gjithësia si qershia” (1986), “Ta shoh botën si gotën” (1988), “Këmbët e erës” (1994), “Shpirti i luleve” (2007), “Tallje e bukur” (2008) etj. (Xhevat Sylja)

DEMIRI Ruzhdi (1957-). Gazetar. Lindi në Podujevë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për shkenca politike i mbaroi në Universitetin e Zagrebit. Më 1982 nis punën e gazetarit në të përditshmen “Rilindja” në Prishtinë. Ishte raportues për zhvillimet në komunën e Prishtinës, komentator, analist, redaktori i rubrikës së politikës së jashtme dhe kryeredaktor i gazetës (1992-1994). Gjatë viteve ’80-’90 shkroi raporte për punën e Kuvendit të Kosovës dhe për ngjarjet politike

të asaj periudhe. Më 1994 emigroi në Zvicër. Ishte njëri nga themeluesit e gazetës “Bota sot” në Zvicër dhe kryeredaktor i parë i saj. Më pas shkroi komente e analiza politike në gazetën “Rilindja” që botohej në Tiranë dhe Zvicër. Jeton në Zvicër. (Zenun Çelaj)

DEMJAHA Bujar (1960-). Inxhinier i arkitekturës, urbanist. Lindi në Ferizaj, shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Prishtinë (1978), ku kreu edhe studimet e arkitekturës dhe më pas studimet pasuniversitare të dizajnit grafik. Studimet e doktoratës në lëmin e planifikimit hapësinor i mbaroi në Universitetin Teknik të Vjenës (2015) dhe të arkitekturës dhe urbanistikës në Sarajevë (2016). Në periudhën 1998-2008 ishte ligjërues për lëndën arkitektura e brendshme në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës. Për punën profesionale në lëmin e enterierit, të arkitekturës dhe të urbanizmit ka marrë një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh: për Kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz (2006), për Muzeun Kombëtar të Arteve Bashkëkohore (2007) dhe për Memorialin “Ibrahim Rugova” në Prishtinë (2013) etj. Është autor dhe bashkautor i disa publikimeve shkencore dhe pjesëmarrës në një sërë projektesh nga fusha e projektimit, mjedisit, turizmit etj. (Vlora Navakazi)

DEMOLLI Arif (1949-2017). Shkrimtar, gazetar, përkthyes letrar. Lindi në fshatin Gllugovicë të Prishtinës. Në Prishtinë mbaroi filloren, shkollën e mesme dhe studimet e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Punoi pak kohë arsimtar, pastaj redaktor në gazetën “Bota e re”, gazetar në Televizionin e Prishtinës, kurse nga viti 1978 në revistën “Fjala”. Më 1981 u dënua me dy vjet burg. Më 1990 u kthye në “Fjala” (përkthyes, redaktor dhe kryeredaktor), pastaj ishte kryeredaktor i “Pionierit”. Ndërkohë udhëhoqi redaksinë e botimeve të “Zërit”. Më 1995 punoi në hartimin e planeve dhe të programeve të përbashkëta të gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Kosovës dhe të Shqipërisë. Nga viti 2003 punoi në Ministrinë e Arsimit të Kosovës, zyrtar për tekste shkollore. Është autor



ARIF DEMOLLI

dhe bashkautor i disa librave të leximit. Shkruan për fëmijë dhe të rritur: poezi, tregime, përralla, romane, pjesë teatrale etj. Është ndër kultivuesit e dalluar të tregimit të shkurtër, sidomos të tregimit humoristik-satirik. Në romanin “Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie” (1993), nëpërmjet syrit të fëmijës shpaloset jeta e një fshati të viteve ‘50-’60 në Kosovë. Shquhet për imagjinatën e bujshme, për gjuhën e pasur dhe për stilin e gdhendur. U prezantua në antologji të ndryshme të prozës shqiptare. Vepra: “Ballkonet e një qyteze” (1979), “Lushi si askushi” (1980), “Vdekja e Akanit” (1990), “Si mbetën gjallë shqiptarët” (1991), “Shkulësit e përjetshëm” (1997), “Libër larush” (2000), “Lulevera dhe Ylberi” (2009), “Në kafaz - tërë gaz” (2011) etj. Ishte laureat i disa çmimeve letrare dhe mirënjohjeve. (Xhevat Sylja)

DEMOLLI Haki (1963-) Jurist, profesor universitar. Lindi në Prishtinë. Në vitin 1985 diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku edhe magjistroi dhe më vonë doktoroi (2001) me temën rreth terrorizmit dhe luftës kundër tij. Po në këtë fakultet u zgjodh asistent (1997) dhe arriti të gjitha gradat universitare, përfshirë edhe titullin profesor i rregullt për lëndën kriminalistika. Nga viti 1999 deri më 2003 ligjëroi në shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës në Vushtrri. Në legjislaturën e katërt dhe të pestë u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës, më 2010 u bë ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa më 2015 ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ka botuar punime shkencore dhe libra nga fusha e interesimit të tij shkencor: “Terrorizmi” (2002), “Kriminaliteti ekonomik në Kosovën e viteve ‘80” (2009) etj. (Blerim Reka)

DEMONSTRATA ANTIBULLGARE E SHKUPIT (1941). Demonstratë e forcave politike të djathta dhe të majta për bashkimin e viseve me shumicë shqiptare me “Tokat e lirueme”. Pas prillit të vitit 1941, disa vise shqiptare të Maqedonisë, të Kosovës dhe të Kosovës Lindore iu bashkuan zonës bullgare të okupimit. Nacionalistët, por edhe komunistët shqiptarë u angazhuan që territoret nën okupimin bullgar t’i bashkoheshin zonës okupuese italiane, apo “Tokave të lirueme”, siç quheshin zyrtarisht territoret që iu bashkuan Shqipërisë më 1941. Për këtë qëllim u orga-

nizuan manifestime protestuese në Shkup, Preshevë, Gjilan, Kaçanik, Tetovë etj. Paria e Kumanovës, e drejtuar nga Shaban Efendiu dhe Jahja Osmani, morën iniciativën që në Shkup të organizohej një konferencë, në të cilën do të trajtohej çështja e çlirimit nga bullgarët e viseve shqiptare dhe bashkimi me “Tokat e lirueme”. Konferenca solli vendimin për themelimin e Lëvizjes për Çlirim e Bashkim (LÇB) në krye me Shaban Efendiun nga Kumanova. Më pas, delegacioni 3-anëtarësh i prirë nga Shaban Efendiu udhëtoi për në Tiranë. Delegacioni mori pëlqimin për organizimin e demonstratës në Shkup më 10 maj. Veprimtarët shqiptarë, si të majtë ashtu edhe të djathtë të viseve nën pushtimin bullgar, si dhe veprimtarët e LÇB-së bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Në paraditen e 10 majit mijëra shqiptarë të prirë nga drejtuesit e LÇB-së u tubuan para ndërtesës së Bojali Hanit në Shkup. Në krye të demonstruesve u gjendën Shaip Mustafa, komunist nga Presheva, Jahja Osmani nga Kumanova, Idriz Hoxha nga Shkupi, Kurtesh Agushi e Vesel Rexhepi, komunistë nga Gjilani, Abdullah Musliu nga Ferizaji dhe shumë veprimtarë të tjerë. Në organizimin e demonstratës dhanë kontributin e tyre edhe shkupjanët: Hasan Shukriu, Qemal Beu, Emin bej Kumbaraxhiu, Shefki Ramiz beu, Abdullah Hoxha etj. Demonstruesit me plisa në kokë dhe me flamurin kombëtar, të grumbulluar para Bojali Hanit me transparente dhe duke brohoritur parullat: “Shkupi është i ynë”, “Shkupi, Kumanova e Presheva janë Shqipni” etj., u nisën drejt çarshisë. Atyre iu bashkuan edhe nxënësit e arsimtarët e Medresesë “Gazi Isa Beu”, të cilëve u printe Bedri Haliti, si dhe një pjesë e qytetarëve të Shkupit, që konsideroheshin turq dhe boshanjakë. Demonstruesit kaluan Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe iu drejtuan Komandës Ushtarake Bullgare, pastaj Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Gjermane, për të vazhduar deri te Konsullata Italiane, në anën e djathtë të Urës së Gurit. Kur demonstruesit kaluan Urën e Gurit, ushtria dhe xhandarmëria bullgare ndërhyri dhe i sulmoi protestuesit. Demonstruesit u kacafytën me xhandarmërinë dhe ushtrinë bullgare, e cila përdori edhe kavalerinë dhe armët e zjarrit. Pas shuarjes së demonstratës, autoritetet bullgare arrestuan organizatorët, në mesin e tyre edhe Shaip Mustafën, Jahja Osmanin, Jahja Saitin, Azem Latif Hoxhën nga Kumanova, Ejup Saitin

nga Shkupi, Shemsi Halimin etj. Disa syresh, si Shaip Mustafa e Jahja Osmani u internuan në kampet e Bullgarisë. Xhandarmëria bullgare arrestoi edhe dy vëllezërit tregtarë të plisave: Mahmutin dhe Hakiun, sepse i kishin furnizuar demonstruesit me plisa. Mahmuti nuk iu përballoi torturave dhe vdiq. Bullgarët arrestuan mbi 300 demonstrues, të cilëve iu grisi plisat dhe i dërgoi në kazermën ushtarake. (Fehmi Rexhepi)

DEMONSTRATAT ANTIFASHISTE (1941-1943). Demonstrata antifashiste të organizuara në kohën e pushtimit italian të Shqipërisë dhe të Kosovës. Demonstratat e para antifashiste u organizuan në nëntor të vitit 1941, në Gjakovë, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë, Shkup, Dibër etj., me rastin e 28 Nëntorit, në 29 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Demonstratat më të fuqishme ishin ato që u organizuan në Gjakovë. Në demonstrata u dëgjuan parulla patriotike dhe antifashiste, ndërsa u grisën flamujt italianë dhe shqiptarë me shenjat e liktorit dhe në vend të tyre u vendosën flamujt kombëtarë. Në fjalimet që u mbajtën përpara masës së tubuar u kritikua politika e fashizmit dhe u kërkua pavarësia e Shqipërisë. Në Prizren manifestimet i organizuan vetë italianët, por ato u shndërruan në demonstrata antifashiste. Po këtë ditë në Mitrovicë, Lidhja Popullore Shqiptare organizoi kremtimin e ditës së Pavarësisë. Rinia e gjimnazit të Prishtinës u përpoq që manifestimin zyrtar ta kthente në manifestim antifashist dhe për këtë shkak u përjashtuan nga shkolla 7 nxënës. Po këtë ditë në Shkup u organizuan demonstrata kundërbullgare, në të cilat shqiptarët kërkuan që ato vise t'i bashkoheshin Shqipërisë. Kështu ndodhi edhe në Dibër. Të këtij karakteri ishin demonstratat e gushtit të vitit 1942 në Prizren, ndërsa si shkas shërbeu pushtimi bullgar i disa fshatrave. Një vit më vonë (1942) në Gjakovë, po në këtë festë, shpërthyen sërish demonstrata. Po këtë ditë, në kafenetë “Romë-Berlin” dhe “Savoja” u organizua shfaqje antifashiste. E njohur ishte edhe demonstrata e Prizrenit e 17 shkurtit të vitit 1943 kundër terrorit fashist, me çrast u grisën fotografi të udhëheqësve fashistë dhe u shkruan parulla antifashiste. Po në këtë muaj demonstrata të këtilla u organizuan sërish në Gjakovë, ku u blagosën disa protestues. (Izber Hoti)

DEMONSTRATAT E JANARIT 1990. Demonstrata të shqiptarëve të Kosovës kundër pushtetit serb dhe jugosllav. Pas fjalimit të S. Milosheviqit në Gazimestan më 28 qershor 1989, Federata Jugosllave u fut në krizë politike. Në janar të vitit vijues Kongresi XIV i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë ndërpreu punimet, duke shpërfaqur mosmarrëveshje të thella ndërmjet kombeve dhe republikave që e përbënin Federatën Jugosllave. Një ditë pas ndërprerjes së Kongresit (24 janar), në shumë qytete të Kosovë shpërthyen demonstrata masive të shqiptarëve, në të cilat u kërkua heqja e masave të jashtëzakonshme, lirimi i të gjithë të burgosurve politikë, ndërprerja e diferencimi politik dhe dorëheqja deri në fund të janarit 1990 e të gjitha strukturave politike të varura nga Beogradi. Në orët e mëngjesit mijëra demonstrues u mblodhën para ndërtesës së Komitetit Krahinor në Prishtinë dhe kërkuan të dilte para tyre kryetari i atij komiteti, Rahman Morina. Demonstruesit brohoritnin parulla për liri dhe demokraci, kërkonin largimin e udhëheqjes aktuale krahinore, zgjedhje të lira dhe lirinë e fjalës. Demonstrata u shpërnda pas një vërsulje të ashpër të policisë. Meqë kërkesat e demonstruesve nuk u plotësuan, 300 mijë qytetarë nënshkruan deklaratën “Për demokraci, kundër dhunës”. Më 26 janar të parët u hodhën në demonstratë minatorët e Trepçës, pastaj punëtorët e Vushtrisë, të Gjilanit, Pejës etj. Demonstrime e përlëshje me policinë u zhvilluan nga 27 deri 31 janar në Prishtinë, Podujevë, Rahovec, Ferizaj, Lipjan, Suharekë etj., me çrast u vranë 33 veta dhe u plagosën mbi 200 të tjerë. (Kosovar Basha)

DEMONSTRATAT E MARSIT 1989. Ardhja në pushtet e Millosheviçit ndryshoi ritmin e politikës në Jugosllavi. Ndryshimet kushtetuese që priteshin të bëheshin, ishin të papranueshme për shqiptarët e Kosovës. Më 28 shkurt 1989, në mitingun e mbajtur në Beograd, Slobodan Millosheviqi shpalosi synimet e tij kundër Kosovës. Më 2 mars 1989 u burgos edhe kryetari i Komitetit Krahinor të Kosovës, Azem Vllasi dhe rreth 300 zyrtarë të Kosovës. Në krye të organeve krahinore u vendosën persona luajalë ndaj Serbisë. Më 23 mars Kuvendi i Kosovës, në atmosferën e dhunës dhe të kërcënimit, votoi amendamentet kushtetuese, të cilat e suprimonin autonominë e Kosovës. Në Serbi votimi i amendamenteve



NGA NJË DEMONSTRATË NË PRISHTINË

kushtetuese dhe heqja e autonomisë së Kosovë u prit me festë. Serbisë iu hap rruga që të merrte në dorë të gjitha ingerencat që i kishte Kosova me Kushtetutën e vitit 1974. Për të kundërshtuar vendimet për ndryshimet kushtetuese anë e kënd Kosovës shpërthyen demonstrata masive. Demonstratat masive të shqiptarëve të Kosovës u zhvilluan nga 23 deri më 29 mars 1989. Në Ferizaj shpërtheu demonstrata e parë, ku 5 mijë vetë u përleshën ashpër me policinë. Ditën e dytë të demonstratave në Ferizaj u arrestuan 174 veta. Demonstratat u shtrinë menjëherë në qytete të tjera të Kosovës. Përleshje pati në Suharekë, Podujevë, Prizren, Prishtinë etj. Në Kosovë u vendos ndalim-qarkullimi, u mbyllën të gjitha shkollat, përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës. Nga 23 deri më 28 mars, kur Kuvendi i Kosovës miratoi amendamentet kushtetuese, u vranë 27 demonstrues shqiptarë, qindra të tjerë u plagosën dhe u arrestuan. (Kosovar Basha)

DEMONSTRATAT E STUDENTËVE (1997).

Protestë e studentëve të Universitetit të Prishtinës, të cilat u pasuan me protesta gjithëpopullore kundër pushtetit okupues serb. Lëvizja Studentore e vitit 1997 drejtohej nga Bujar Dugolli, kryetar i Unionit të Pavarur Studentor, Albin Kurti, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi, të përkrahur nga rektori i Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci, si dhe nga profesorët e të gjitha fakulteteve. Rreth 30,000 studentë dhe profesorë, si dhe intelektualë të tjerë dhe mbi 100.000 qytetarë shqiptarë dolën në rrugë e sheshe në mbështetje të kërkesës së studentëve të Universitetit të Prishtinës (UP) për lirim e objekteve shkollore dhe universitare të uzurpuara nga regjimi serb vite më parë. Marshi i protestuesve u nis nga



DEMONSTRATAT E STUDENTËVE (1997)

lagjja “Velania”, ndërsa në udhëkryqin e “Tauk Bahçes” u ndaluan nga një kordon i madh i policisë speciale serbe të pajisur me makineri të blinduara, me armë dhe shkopinj gome. Në ballë të protestave ndodhej rektori i UP-së, Ejup Statovci, bashkë me liderët e lëvizjes studentore. Edhe pse protestat ishin paqësore autoritetet serbe u përgjigjën më arrestime dhe dhunë brutale. Radhët e studentëve, profesorëve dhe qytetarëve u sulmuan me gaz lotsjellës nga helikopteri i policisë serbe dhe nga njësitet e policisë speciale. Me atë rast u arrestuan rektori Ejup Statovci, prorektori Ahmet Gecaj, pastaj liderët e studentëve, Bujar Dugolli, Albin Kurti, Driton Lajçi, Lulëzim Jagxhiu etj. Përfaqësues të shumtë diplomatikë dhe të medieve të njohura ndërkombëtare ndoqën me vëmendje ngjarjet në ditën e protestës. Gjendja u tensionua në mbarë Kosovën. Përdorimin e dhunës ndaj protestuesve paqësorë dhe arrestimet e shumta i dënuan të gjitha forumet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në shtetet perëndimore. (Luan Tetaj)

DEMONSTRATAT E VITIT 1968. Demonstrata masive të rinisë dhe të popullit shqiptar të Kosovës, me kërkesën kryesore që Kosovës t'i njihej statusi i republikës në kuadër të Federatës Jugosllave. Në periudhën pararendëse, me diskutimet për ndryshimet kushtetuese, me Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, me manifestimet me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut dhe me lëvizjet studentore në Europë, në Kosovë tashmë u krijua një klimë politike e favorshme për kërkesa rreth avancimin të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi. Kështu, gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1968, në shumë qytete të Kosovës shpërthyen demonstratat masive të



NGA DEMONSTRATAT E VITIT 1968

rinisë dhe të popullit shqiptar, të cilat patën si kërkesë kryesore njohjen e statusit të republikës për Kosovën dhe të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje. Demonstrata e parë në Kosovë u organizuan në Prizren, më 6 tetor 1968. Në mënyrë simbolike kjo demonstratë filloi dhe përfundoi para ndërtesës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku për herë të parë në mënyrë publike u kërkuva Kosova Republikë. Demonstratë e ngjashme u organizua edhe në Suharekë, më 8 tetor dhe në Pejë, më 19 tetor 1968. Këto ishin demonstratat e para në Kosovë të organizuara nga rinia studentore, pas Luftës së Dytë Botërore. Më 27 nëntor 1968 u organizuan demonstrata masive në Prishtinë, në Podujevë, në Gjilan dhe në Ferizaj. Demonstrata më e madhe dhe më masive ishte ajo e Prishtinës, ku demonstruesit, me pankarta dhe duke brohoritur parulla u nisën nga Fakulteti Filozofik (sot Filologjik), duke marshuar në drejtim të qendrës së qytetit, deri te Kuvendi i Kosovës, për t'u ndalur te sheshi para Teatrit Krahinor. Demonstruesit gjatë marshimit në qytet u ndeshën në qëndrimin e ashpër të organeve policore. Në përleshjet ndërmjet policisë dhe demonstruesve, u vra nxënësi Murat Mehmeti. Demonstrata e Prishtinës zgjati prej orës 15.40 e deri në orët e vona të mbrëmjes së 27 nëntorit të vitit 1968. Edhe në demonstratat që u organizuan në Gjilan, në Ferizaj e në Podujevë, demonstruesit u përleshën me forcat policore. Kërkesat dhe parullat kryesore të demonstruesve ishin: “Duam Republikë”, “Vetëvendosje deri në shkëputje”, “Kushtetutë”, “Universitet”, “Poshtë politika kolonialiste ndaj Kosovës”, “Për të drejtat tona edhe gjak do të derdhim” etj. Demonstratat e vitit 1968 në Prishtinë i organizoi grupi i studentëve të Prishtinës, ku

bënin pjesë: Adil Pireva, Afrim Loxha, Hasan Dërmaku, Ilaz Pireva, Osman Dumoshi, Skënder Kastrati, Skënder Muçolli, Selatin Novosella dhe Xheladin Rekalui.

Një muaj më vonë më (23 dhjetor 1968) u demonstrua edhe në Tetovë. Organizatorë ishin studentët shqiptarë nga Tetova, që studionin në Universitetin e Beogradit dhe në fakultetet e Prishtinës. Përkrahës ishin edhe shumë veprimtarë, të cilët nuk pajtoheshin me shtypjen e vazhdueshme të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë. Demonstruesit rreth orës 11 të 23 dhjetorit u nisën nga qendra e qytetit dhe u futën në ndërtesën e Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve. Ata marshuan me flamur kombëtar dhe e ngritën atë në një shtyllë 6 metrash të lartë në qendër të Tetovës. Pas kërcënimeve me orë policore, demonstruesit u shpërndanë dhe kështu përfundoi demonstrata njëditëshe. Demonstrata e fundit që u organizua atë vit dhe që ishte jehonë e demonstratave të Kosovës, është ajo e Ulqinit, që u mbajt më 3 qershor 1969. Në fund të vitit shkollor 1968-1969 nxënësit edhe arsimtarët e shkollës fillore të Tërstenikut organizuan ekskursion në Ulqin. Gjatë qëndrimit në Ulqin ata u shoqëruan me nxënësit dhe rininë e Ulqinit, sidomos përmes këngëve patriotike për figurat historike shqiptare. Ditën që do të niseshin për në Kosovë (3 qershor 1969), nxënësit manifestuan nëpër qytet, të shoqëruar nga të rinj e popullsia e Ulqinit. Më pas, me insistimin e policisë malazeze, filluan ndjekjet dhe persekutimet ndaj drejtorit dhe arsimtarëve të shkollës së Tërstenikut, që kishin shoqëruar nxënësit gjatë ekskursionit në Ulqin.

Demonstatat e vitit 1968 për herë të parë nxorën në shesh problemin e madh shqiptar në Jugosllavi, të cilin deri atëherë pushteti jugosllav ishte përpjekur ta mbante të mbyllur në mënyra të ndryshme. Pavarësisht nga ashpërsia me të cilën u përgjigj pushteti i atëhershëm, demonstratat patën efekt jashtëzakonisht të rëndësishme në përshpejtimin e disa proceseve në Kosovë: u shpejtua themelimi i Universitetit të Prishtinës, u miratuan amendamentet kushtetuese me të cilat u avancua statusi i Kosovës, u përshpejtua zhvillimi ekonomik i saj, u themeluan institucione të reja dhe intensifikua bashkëpunimi kulturor dhe arsimor me Shqipërinë. (Fehmi Rexhepi)

DEMONSTRATAT E VITIT 1981. Demonstrata masive të të rinjve dhe të popullit të Kosovës, që shënuan kthesë të rëndësishme në zhvillimet e atëhershme politike dhe një-



PAMJE NGA DEMONSTRATAT E VITIT 1981

kohësisht paralajmëruan të gjitha zhvillimet e mëvonshme dramatike, të cilat çuan deri të shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe deri te pavarësia e Kosovës. Në demonstrata fillimisht u përfshinë studentët e Universitetit të Prishtinës, e më pas edhe punëtorët dhe qytetarët shqiptarë të mbarë Kosovës. Demonstratat filluan në mbremjen e 11 marsit 1981, me kërkesa sociale të studentëve, për t'u shfaqur më pas me kërkesa politike. Vala e demonstratave nuk u ndal vetëm në Prishtinë. Më 15 mars ato u zhvilluan në Prizren, ku morën pjesë studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme. Më 26 mars, me rastin e arritjes së stafetës së Titos në Prishtinë, studentët organizuan një demonstratë të re. Demonstratat ndërmjet 26 marsit e 1 prillit, përveç në Prishtinë, u përhapën edhe në qytetet e tjera të Kosovës. Tejkalime, prishje të rendit e qetësisë publike pati në Prizren, Obiliq, Ferizaj, Podujevë, Vushtrri etj. Më 30 mars u organizuan demonstrata edhe në Obiliq. Një nga demonstratat më masive ishte ajo që u organizua në Prishtinë më 1 prill, ku morën pjesë disa mijëra veta. Parullat që dëgjoheshin nga altoparlanti apo paraqiteshin në pankarta ishin të ngjashme me ato të vitit 1968: "Kosova Republikë", "Jemi shqiptarë, jo jugosllavë",

"Trepça jonë", "Kosova-kosovarëve", "Bashkim-Bashkim" etj. Rreth orës 18.30 demonstruesit u mblodhën para godinës së Komitetit Krahinor. Policia, për t'i shpërndarë protestuesit, përdori gaz lotsjellës dhe bomba tymuese. Po atë mbremje në Prishtinë ndërhyri edhe ushtria jugosllave. Ajo siguronte godinat publike dhe pikat strategjike të qytetit. Sipas të dhënave zyrtare, gjatë kësaj demonstrate pati 9 qytetarë të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa nga forcat e policisë u vranë 2 veta dhe 17 u plagosën.

Më 2 prill 1981, Beogradi shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë dhe ndalim-qarkullimin. Këshilli Ekzekutiv i Kosovës, me një vendim të veçantë, i ndërpreu mësimet në shkollat fillore, të mesme e fakultete dhe i mbylli konviktet e studentëve dhe të nxënësve në Prishtinë. Masa të ngjashme u morën edhe në komunat e tjera të Kosovës. Megjithkëtë, më 2 prill në Prishtinë vazhduan tërë ditën demonstratat. Po atë ditë, demonstratat u organizuan edhe në Podujevë, në Gjilan, në Vushtrri, në Lipjan, në Glllogoc (Drenas), në Gjakovë etj., ndërsa më 3 prill në Ferizaj, Viti, Vushtrri dhe Mitrovicë, më 30 prill në Deçan dhe Istog. Në këtë vazhdë, më 18 maj 1981 rreth 1,000 studentë demonstruan për një orë e gjysmë në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Pas kësaj, organet e pushtetit e mbyllën vitin akademik 1980-1981 në Universitetin e Prishtinës. Shpallja e gjendjes të jashtëzakonshme në Kosovë në prill të vitit 1981 ishte e para në historinë e Jugosllavisë, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme u ndalua edhe hyrja në vend e gazetarëve vendorë dhe të huaj. Lidhjet e Kosovës me botën e jashtme u ndërpreu pothuajse tërësisht. Për të nënshtruar shqiptarët, gjatë marsit dhe prillit të vitit 1981, pushteti jugosllav solli në Kosovë njësitë shumta të policisë speciale dhe forca ushtarake, të cilat arrinin në rreth 60.000 veta. Demonstratat e vitit 1981 shpërthyen në kohën kur Kosova në rrafshin politik, ekonomik dhe kulturor-arsimor kishte arritur nivelin më të lartë të zhvillimit. Pas këtyre demonstratave filloi një fushatë e egër antishqiptare në mbarë ish-Jugosllavinë. Në Kosovë u zhvillua një proces i egër i diferencimit ideopolitik. Nga pushteti u larguan autonomistët në krye me Mahmut Bakallin dhe ata u zëvendësuan me strukturat e hershme të para Plenumit të Brionëve, ose me luajalistët e rinj të

Serbisë. Shkaktarin kryesor të “shpërthimit të nacionalizimit shqiptar në Kosovë”, Serbia e gjeti te Kushtetuta e vitit 1974, tek autonomia e gjerë e Kosovës dhe tek avancimi i të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi. Marrëdhëniet shqiptaro-serbe u ashpërsuan së tepërmi. Në horizont filloi të shquhej qartë një konflikt përmasash të mëdha. (Fehmi Rexhepi)

DENDËSIA AGRARE. Numri i popullsisë bujqësore në raport me sipërfaqet e tokës së punueshme, quhet dendësi agrare. Është ky një tregues i rëndësishëm demografik, që lidhet me aktivitetin ekonomik të popullsisë. Pjesëmarrja e veprimtarisë bujqësore në ekonominë e një vendi përcakton pjesëmarrjen e popullsisë agrare në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Në regjistrimin e vitit 1948, Kosova kishte 80.09% popullsi agrare. Në dekadat në vijim, përqindja e popullsisë agrare në Kosovë ka shënuar rënie të vazhdueshme. Derisa në vitin 1961 kishte 64.2% popullsi agrare, në vitin 1981 ky numër bie në 24.6%, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) përqindja e popullsisë agrare në Kosovë ishte vetëm rreth 7%. (Hazer Dana)

DENDËSIA E POPULLSISË. Me dendësi të popullsisë nënkuptojmë raportin në mes të numrit të banorëve dhe sipërfaqes së një vendi. Sipërfaqja llogaritet për km^2 , e cila pjesëtohet për kokë banori, duke nxjerrë si përfundim mesataren e sipërfaqes së tokës për një banor. Rritja e numrit të popullsisë në një territor sjell rritjen e dendësisë së popullsisë. Kjo ka për rrjedhojë zvogëlimin mesatar të sipërfaqes për kokë banori. Nga viti 1948, dendësia e popullsisë në Kosovë ka shënuar rritje të vazhdueshme, krahas rritjes së vazhdueshme të popullsisë. Derisa në vitin 1948 dendësia e popullsisë ishte 66.6 b/km^2 , sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011) Kosova ka dendësi mesatare prej 159.5 b/km^2 . Dendësia do të duhej të ishte edhe më e madhe, meqenëse regjistrimi i fundit nuk është zhvilluar në tërë territorin e Kosovës (veriu i Kosovës), ndërsa nuk janë regjistruar as emigrantët, as personat me punë të përkohshme në botën e jashtme. (Hazer Dana)

DEPOZITI. Një llogari kursimi, llogari rrjedhëse ose ndonjë lloj tjetër i llogarisë bankare që lejon të depozitohen dhe të tërhiqen para nga mbajtësi i llogarisë. Këto transaksione

regjistrohen në librat e bankës dhe bilanci që rezulton është i regjistruar si një detyrim për bankën dhe përfaqëson shumën që banka i detyrohet konsumatorit. Disa banka mund të aplikojnë një tarifë për këtë shërbim, ndërsa të tjerat mund t’u paguajnë konsumatorëve interes mbi fondet e depozituara. Depozitat mund të mbahen në formë të depozitave të transferueshme ose depozitave të tjera. Depozitat e transferueshme përfshijnë të gjitha depozitat që janë të shkëmbyeshme pa kufizim dhe që janë drejtpërdrejt të përdorshme për kryerjen e pagesave me çek, kartelë debiti/kreditit, ose përmes ndonjë instrumenti tjetër të pagesës. Depozitat e tjera përfshijnë të gjitha kërkesat, përveç depozitave të transferueshme, që përfaqësohen me një dëshmi të depozitimit. Format tipike të depozitave të përfshira në këtë klasifikim janë depozitat në të parë që lejojnë tërheqje të menjëhershme të të hollave, por që nuk lejojnë transferet e drejtpërdrejta te palët e treta, pastaj depozitat e kursimit dhe depozitat me afat të fiksuar. Depozitat mund të mbahen në valutë kombëtare, por edhe në valutë të huaj. Depozitat bankare në Kosovë në vitin 2014 kanë arritur në 2,5 miliardë euro, apo rreth 43% të prodhimit të brendshëm bruto. Struktura e depozitave në sektorin bankar dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.8% të të gjitha depozitave, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve me pjesëmarrje prej 22.1%. Në vitin 2014 pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme, të cilat përbënin 47.2% të të gjitha depozitave. Depozitat e afatizuara përbënin 31.7%, ndërsa ato të kursimit u përfaqësuan me 16.5%. Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, pjesëmarrjen më të lartë prej 50.5% vazhdojnë ta kenë depozitat me afat më të shkurtër maturimi, përkatësisht depozitat me afat maturimi deri në një vit. (Valentin Toçi).

DERMAKU Sabit (1948-). Biolog, profesor universitar. Lindi në Shipashnicë të Epërme, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Hogosht, gjimnazin në Gjilan dhe studimet për biologji në Universitetin e Prishtinës (1972). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoroi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës. Pas studimeve, një kohë punoi mësimdhënës i

biologjisë në gjimnazin e Kamenicës. Në vitin 1975 pranohet asistent në katedrën e biologjisë të FSHMN-së në Prishtinë. Me titullin e docentit ligjëroi lëndën e biogeografisë në katedrën e gjeografisë dhe zoologjisë së përgjithshme në Fakultetin e Bujqësisë. Në vitet në vijim i arrin të gjithë titujt universitarë për lëndën e biokimisë. Ka të publikuara disa punime shkencore nga fusha e biokimisë brenda dhe jashtë vendit, kumtesa, tekste shkollore dhe është autor i tekstit universitar "Biokimia". (Fetah Halili)

DERSHKOVA (DËRSHKOVINA/DRASHKOVINA). Njëra ndër njësitë territoriale mesjetare (serb. župa), të krijuara nga Principata e Rashës, që përfshinte një pjesë të Drenicës së sotme. Dokumenti më i moçëm, në të cilin përmendet kjo krahinë është një kartë e padatuar e princit rasian Mirosllav, që ishte njëri nga tre vëllezërit e Stefan Nemanjës. Dokumenti do të jetë shkruar para viteve 1253-54. Nga ky burim merret vesh se Mirosllavi, përveç pronave në rajonin e Limit, zotëronte edhe dy katunde në territorin e sotëm të Kosovës: Rakoshin në rrethina të Pejës dhe Kryshecin në Dërshkovinë, përkatësisht në rrethina të Skënderajt të sotëm. Kufijtë e katundit Kryshec shtriheshin deri te Përroi i Deviçit dhe te Përroi i Arbanasëve. Krahina përfshinte katundet: Kryshec, Llaushë, Runikë e ndonjë tjetër në krahinën e Drenicës deri në brigje të lumit Klina. Ekziston edhe një pikëpamje tjetër, sipas së cilës krahina e Dërshkovës do të jetë shtrirë deri në rrethina të qytezës së Klinës, sepse katundi i sotëm Dollc, përkatësisht lokaliteti arkeologjik Selishta i këtij katundi ruan gjurmët e një vendbanimi që mund të jetë ngritur në shek. XIII-XIV dhe ishte pjesë përbërëse e rajonit Dërshkovina. Vetë emri Dërshkova nuk është ruajtur në traditën e shqiptarëve, gjë që bën të ditur se kemi të bëjmë me një emër librar. Nuk ka dëshmi të shkruara, kur emrin Dërshkovina e mbuloi emri më i ri Drenica, përveç një dëshmie të gjysmës së parë të shek. XIV, kur përmendet lumi Drenica. (Skënder Gashi)

DERVARI. Fshat në komunën e Vushtrrisë, rreth 7 km në jug të qytetit. Është vendbanim i vjetër, që e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike (themele të shtëpive, gypa të ujit, enë etj.). Si vendbanim me këtë emër përmendet

në defterin kadastral të vilajetit Vëllk (1455), që kishte 29 shtëpi. Në gjysmën e dytë të shek. XIX këtu vendosen disa familje muhaxhirësh, si Jashanica, Gërguri dhe Breznica, të dëbuar nga Sanxhaku i Nishit. Sipas regjistrimit të vitit 1913 fshati kishte 346 banorë, kurse para luftës së viteve 1998-99 kishte rreth 1,200 banorë. (Skender Halimi)

DERVISHAJ Menderes (1973-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Zabllaç të komunës së Istogut. Që herët emigroi në Zvicër dhe më pas në Gjermani. U kthye në Kosovë pas Epopesë së Jasharajve. Punoi në logjistikë, në furnizim me armë deri me themelimin e Brigadës 133 "Adrian Krasniqi" (janar 1999), e cila veprimi në trekëndëshin Pejë-Istog-Klinë. U sistemua në batalionin e parë të kësaj brigade. Ra dëshmor më 8 maj 1999 në betejën e zhvilluar tek Ura e Çetajve mbi lumin Drin, në fshatin Trubuhoc, së bashku me shtatë luftëtarë të tjerë. (Fetnete Ramosaj)

DERVISHAJ Menhend (1974-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Zabllaç të Istogut. Në maj të vitit 1998 iu bashkua radhëve të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit, në Glllogjan. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në vijat e para të frontit në Voksh, pastaj në Junik, Gjocaj, Jasiq, Smolicë, Glllogjan e në fshatra të tjera të komunës së Deçanit dhe të Gjakovës. Pas ofensivës së shtatorit '98, për disa muaj veprimi në rajonin e Rugovës, ku kontribuoi në themelimin e Brigadës 136 të Zonës Operative të Dukagjinit. U angazhua në luftën e UÇK-së në rajonin e Istogut dhe për formimin e Brigadës 133 "Adrian Krasniqi", e cila operonte në trekëndëshin Pejë-Klinë-Istog. Ishte zëvendëskomandant i njësitit special të Brigadës 133 "Adrian Krasniqi". Ra dëshmor në luftimet e zhvilluara në Osdrim të Pejës më 28 maj 1999. (Fetnete Ramosaj)

DERVISHAJ Musa (1964-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Kosterc të komunës së Skënderajt. Kreu Shkollën e Lartë Teknike në Ferizaj. Një kohë punoi në ndërmarrjen transportuese "Kosovatrans" dhe më pas në Qendrën Shkollore Teknike në Skënderaj. Ishte i përfshirë në organizimin lokal të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës iu bashkua në mars të vitit 1998. U emërua shef i personelit të

Brigadës 112 “Arben Haliti” dhe komandant i batalionit të tretë të kësaj brigade. Mori pjesë në betejën e Çitakëve (maj 1998), ndërsa u plagos në shtator në Kostërc. U trajtua fillimisht në spitalin ushtarak në Abri, pastaj në spitalin e Tiranës dhe në Hanover të Gjermanisë. Nga janari i vitit 1999 u kthye sërish në Kosovë, në Zonën Operative të Drenicës, ku vazhdoi luftën deri në përfundimin e saj. (Haxhi Ademi)

DERVISHEVIQ Rexho (Redžo Dervišević) (1929-1992). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në fshatin Gërçar, Gusi (Mali i Zi). Shkollën fillore e kreu në Gusi, të mesmen në Bor (Serbi). Në vitin 1956 punësohet si teknik i xehetarisë në minierën “Trepça” në Stantërg. Më pas kreu studimet e larta në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit. Pas studimeve bëhet drejtues i njësisë për prodhimin e materialit për mbushje (kerëndisë) dhe më vonë drejtues i prodhimit të xeherorit. Në vitin 1971 u zgjodh drejtor i minierës “Tepça” me flotacion në Stantërg. Në vitin 1979 u zgjodh zëvendësdrejtor gjeneral i kombinatit “Trepça”, ndërsa në periudhën 1988-1992 ishte drejtor në Kishnicë dhe Novobërdë dhe një kohë të shkurtër edhe drejtor i minierës “Trepça” në Stantërg (1991). (Shyqeri Kelmendi)

DERVISHËT. Nga persishtja: i varfër, lypës, i vobektë. Mysliman i përkushtuar ndaj Zotit, i cili nëpërmjet izolimit ose përkatësisë ndaj ndonjë tarikati mistik dëshiron t'i afrohet krijuesit. Deri në shek. XII vepruan individualisht. Doktrina e tyre bazohet në misticizmin islam/sufizëm. Janë profilizuar kryesisht dy drejtime: shkolla e Basrës dhe ajo e Bagdadit. Dervishët, sikur edhe vetë misticizmi islam, kanë kaluar nëpër tri periudha: klasike, mesjetare dhe moderne. Aktualisht nuk kanë ndonjë rol politik apo shtetëror në botën myslimane, por veprojnë individualisht ose në grupe të vogla nëpër gjithë botën. Në trojet shqiptare kanë një rol të caktuar, sepse qysh në mesjetë kanë depërtuar, duke përhapur fenë islame dhe duke shërbyer si urë lidhëse ndërmjet kulturave e qytetërimeve. (Nexhat Ibrahimimi)

DERVODELI Januz (1955-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Magurë, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Hogosht, normalen në Gjilan. Më pas studioi

pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi (1996) dhe doktoroi (2005). Në vitin 1983 u zgjodh asistent, më pas edhe mësimdhënës në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht të Fakultetit të Edukimit. Punoi edhe në Universitetin e Tetovës, në Universitetin e Gjilanit dhe në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Fushë e interesimit të tij shkencor-profesional është pedagogjia e përgjithshme, orientimi profesional dhe standardet në arsim. Publikoi disa punime në gazeta dhe revista. Është autor i veprave: “Informimi dhe orientimi profesional” (1997), “Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe” (2010) dhe “Standardet në arsim” (2015). (Demë Hoti)

DERRALLA Mehmet Hasan pashë (1847-1918) udhëheqës ushtarak dhe ministër i parë i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit. Lindi në fshatin Gradec në rrethinën e Tetovës. Mësimet e para i mori në vendlindje, për të vazhduar më pas shkollën e mesme në gjimnazin e Manastirit. Studimet i vazhdoi në Shkollën Ushtarake në Stamboll. Pas përfundimit të studimeve, ushtroi një varg funksionesh në ushtrinë osmane. Ndërkohë, bëri karrierë edhe në xhandarmerinë osmane. Si profesionist i kësaj fushe u gradua nga qeveria e Stambollit dhe u dërgua në misionet e ndryshme ushtarake në krahinat e Perandorisë. Në cilësinë e ushtarakut shërbeu edhe në vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit. Që herët ra në kontakt me udhëheqës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në moshë të re mori pjesë në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe më pas ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Lidhjes së Pejës më 1899. Gjithashtu ishte pjesëmarrës aktiv dhe udhëheqës i kryengritjeve të viteve 1908-1912. Mori pjesë në Kuvendin e Pavarësisë në Vlorë. Në qeverinë kombëtare të Ismail Qemalit, M. Derralla u emërua ministër i Luftës. Për shkak të aktivitetit të vazhdueshëm në mbështetje të lëvizjes kombëtare shqiptare, u ndoq nga qeveria e Stambollit dhe, pas vitit 1916, edhe nga Serbia dhe Mali i Zi. U vra në Podgoricë më 1918. (Frashër Demaj)

DESIVOJCA Shefki (1894-1944). Veprimtar i lëvizjes antikomuniste. Lindi në fshatin Desivojcë të Kamenicë. Gjatë Luftës së Dytë

Botërore u angazhua në mbrojtje të kufirit lindor të Kosovës nga njësitet çetnike. Gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1944 udhëhoqi forcat vullnetare në luftë kundër njësiteve partizane në rajonin e Kamenicës dhe më gjerë. Nuk u pajtua me vendosjen e pushtetit komunist pas nëntorit të vitit 1944. Kur në Tërpezë (dhjetor, 1944) u vendos mobilizimi i vullnetarëve, Sh. Desivojca u emërua anëtar i shtabit të rezistencës, i cili udhëhoqi aksionin për çlirimin e Gjilanit. Gjatë sulmin në Gjilan Sh. Desivojcës iu caktua për detyrë të udhëhiqte forcat vullnetare, të sulmonin në drejtim të Malishevës së Gjilanit dhe më pas të lironte të burgosurit në burgun e Gjilanit. U vra në përballje me forcat partizane dhe të OZN-ës, në përpjekje për të marrë nën kontroll burgun e Gjilanit. (Naim Musliu)

DESIVOJCA. Fshat në komunën e Kamenicës, rreth 12 km larg qendrës komunale. Shtrihet në skajin lindor të Republikës së Kosovës. Është vendbanim kodrinor-malor me lartësi mbidetare 680-860 m, me peizazhe të bukura dhe bimësi të zhvilluar. Lumi i Desivojcës kalon përmes këtij vendbanimi, duke e ndarë atë në dy pjesë. Pas luftës së fundit ky vendbanim është përfshirë nga valët intensive të shpopullimit. Kjo është reflektuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të popullsisë. Derisa në vitin 1948 kishte 878 banorë, në vitin 2011 u regjistruan 177 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë blegtoria dhe pylltaria. Në fshat funksionon shkolla 9-vjeçare. (Muhamed Kallaba)

DESKOVA Violeta (1954-). Balerinë. Lindi në Shkup. Si pjesëtare e trupës së baletit në Teatrit Popullor Krahinor (TPK) luajti në këto shfaqje: “Halili dhe Hajria” të kompozitorit Tish Daija (1979), me rolin e Smirëzezës luajti në shfaqjen “Vallja pranverore” të Gazmend Zajmit (1981) etj. U dallua edhe me rolin e Zanës në shfaqjen “Interplay” të Morton Gullit (1984) si dhe në shfaqje të tjera të Trupës së Baletit në kuadër të TPK-së. (Arian Krasniqi)

DESKU Arlinda (1975-). Gazetare. Lindi në Klinë, ku edhe kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studioi për drejtësi dhe gazetari në Prishtinë. Gjatë viteve 1998/99 raportoi nga zonat e luftës në Kosovë. Nga viti 1999 deri në vitin 2001 ishte korrespondente nga Kosova e

seksionit shqip të Radios gjermane “Deutsche Welle” dhe nga viti 2000 deri më 2001 ishte gazetare që ndiqte zhvillimet politike në të përditshmen “Zëri”. Nga viti 2001-2005 ishte kryeredaktore e gazetës së përjavshme “Java”. Është bashkautore e librit “A po krijohet identiteti kosovar”, botuar nga “Java” më 2005. Nga viti 2005 deri në vitin 2010 ishte redaktore e politikës dhe zëvendëskryeredaktore e të përditshmes “Express”. Gjatë kësaj periudhe ndoqi negociatat politike për përcaktimin e statusit final të Kosovës, intervistat e veçanta politike, si dhe temat hulumtuese. Që nga viti 2014 është e angazhuar si kryeredaktore në mediumin online në Kosovë “Politiko”, si njëra nga themelueset e tij. (Artan Krasniqi)

DESKU Tahir (1957-2005). Poet, gazetar. Lindi në Siqevë të Klinës. Shkollimin e kreu në Ujmirë dhe Klinë, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Në fillim punoi si gazetar në gazetën e studentëve “Bota e re”, më pas në Televizionin e Prishtinës. Disa vjet qëndroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një kohë e udhëhoqi revistën kulturore dhe shkencore “Tribuna”, e cila botohej në Prishtinë. Në vitet 1988-1999, gjatë luftës në Kosovë ishte në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kryente detyrën e reporterit nga zonat e luftës. Më pas ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Ndër botimet e tij poetike janë: “Prejardhja e dashurisë” (1982), “Nga biografia e pashkruar” (1984) “Idil e vetmi” (1989) dhe “Engjëjt e lirisë” (2000). Pas vdekjes, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës e botoi librin e tij me poezi “Në cilin gjeth e kam vdekjen”(2006), ndërkaq Shtëpia Botuese “Olymp” e botoi veprën e tij të plotë me titullin “Kam mundur të vdes”(2013). Është nderuar me disa çmime për letërsi dhe gazetari, si dhe për kontributin e tij dhënë në periudhën e luftës. Në vitin 2009 Kuvendi Komunal i Klinës e themeloi manifestimin letrar “Ora e Tahir Deskut”. (Sali Bashota)

DESNICKAJA Agnja (Agnia Desnitskaya) (1912-1992). Gjuhëtare ruse. Doktore e shkencave filologjike (1946), anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik (1964), themeluese e shkollës ruse të albanologjisë. I mbaroi studimet për filologji gjermane në Leningrad. Puna e saj lidhej me degën e Leningradit të Institutit të Gjuhësisë të



AGNJA DESNICKAJA

Akademisë së Shkencave (sot Instituti i Studimeve Linguistike), ku ka qenë drejtuese e degës (1963-1976) dhe kryetare e sektorit të studimeve krahasuese të gjuhëve indoeuropiane dhe të gjuhësisë areale (1976-1988). Më 1949 u zgjodh profesore e katedrës së gjuhësisë së përgjithshme në Universitetin Shtetëror të Leningradit. Me iniciativën e Desnickajas në katedër u themelua dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe (1957), ku ajo mbajti mësimet e gjuhës dhe ligjëroi lëndë të ndryshme në fushën e studimeve albanologjike. Më 1946 mbrojti tezën e doktoratës “Zhvillimi i kategorisë së kundrinës së drejtë në gjuhët indoeuropiane” (Razvitie kategorii prjamogo dopolnenija v indoevropskikh jazykah). Botoi një varg artikujsh për gjuhësinë indoeuropiane, gjuhësinë e përgjithshme, sociolinguistikën, historinë dhe metodologjinë e studimeve linguistike. Punime të zgjedhura u përmbledhën në vëllimin “Gjuhësia historike-krahasuese dhe historia e gjuhëve” (Srvnitelnoeazykoznanie i istorija jazykov, Leningrad 1984). Vendin e parë në rrafshin e gjerë të interesave kërkimore-shkencore të Desnickajas e zunë albanologjia dhe ballkanistika. U interesua për historinë e lashtë të shqipes dhe kontaktet e saj të hershme me gjuhët përreth, posaçërisht me gjuhët sllave dhe romane. Vëmendje të veçantë u kushtoi lidhjeve të shqipes me gjuhë të tjera indoeuropiane. Në veprën “Gjuha shqipe dhe dialektet e saj” (Albanskij jazyk i ego dialekty, 1968), që u botua dhe shqip (1972), dha një pasqyrë të ndarjes dialektore të shqipes dhe të fakteve historike që kanë ndikuar në të. U mor me çështjen e formimit të gjuhës letrare shqipe dhe me çështjen e koineve mbidialektore. U mor edhe me studimet e folklorit dhe të letërsisë: bëri skicën e historisë së letërsisë shqipe deri në shek. XX (1987) dhe përgatiti kërret për letërsinë shqipe të shek. XVIII- XIX në botimin 9-vëllimesh kushtuar historisë së letërsisë botërore (1988, 1999, 1991). Vëmendjen e saj e tërhoqën tipare të strukturës morfologjike të shqipes. Veprroi si autore, redaktore dhe udhëheqëse në përpunimin e veprave kolektive kushtuar çështjeve të ballkanologjisë: “Struktura gramatikore e gjuhëve ballkanike” (Grammatičeskij stroj balkanskij jazykov, Len-

ingrad 1976), “Problemet e sintaksës së gjuhëve të arealit ballkanik” (Problemy sintaksisa jazykov balkanskogo areala, Leningrad 1979), “Çështje të adaptimit të elementit gjuhësor latin në arealin ballkanik” (Romano-Balcanica. Voprosy adaptacii latinskogo jazykovogo elementa v balkanskom areale, Leningrad 1987), “Bazat e gjuhësisë ballkanike” (Osnovy balkanskogo jazykoznanija Leningrad 1990)) etj. Në Shqipëri qëndroi më 1946, 1956 dhe 1959 me qëllim studimi. Në vitet 1977, 1983, 1985, 1986, 1987 mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. (Marija Morozova)

DESHPALI Pal (1934-). Kompozitor dhe dirigjent i Arbëneshit të Zarës. Lindi në Blato të Korçullës, djalë i Shime Deshpalit. Kreu studimet për dirigjent e kompozitor (1960) në



PAL DESHPALI

Akademisë e Muzikës në Zagreb. Ishte violinist i Filarmonisë së Zagrebit dhe asistent në Akademisë e Muzikës. Në vitet 1962-67 ishte shef-dirigjent i Orkestrës Simfonike të Radio-televizionit të Zagrebit dhe mysafir e dirigjent i Operës së Zagrebit. Nga viti 1963 udhëheqës i Orkestrës Kamerale të RTV Zagrebit. Më 1961 themeloi festivalin “Mbrëmjet Muzikore të Donatit” në Zarë, më 1966 Ansamblin kameral të Beogradit. Nga viti 1967 veprroi në SHBA dhe nga viti 1970 ishte drejtor muzikor i Orkestrës Simfonike të Floridës, më pas mysafir-dirigjent i festivalit në “Chikago Grant Park”. Nga viti 1974 dhe nga 1981 ishte shef dirigjent i Filarmonisë së Zagrebit dhe udhëheqës i programit muzikor në Festivalin “Lojërat Verore të Dubrovnikut”. Në repertorin e tij prej dirigjenti ka pasur vepra kompozitorësh botërorë, por dhe bashkëkohorë kroatë etj. (Zequirja Ballata)

DESHPALI Shime (1897-1968). Kompozitor dhe shkrimtar i Arbëneshit të Zarës, drejtues koreshe dhe kompozitor. Kreu arsimimin muzikor në Zarë. Ishte drejtues orkestrinash frymore në Dalmaci. Gjatë Luftës së Dytë Botërore udhëhoqi grupe kulturore-artistike. Mbarimin e luftës e priti si dirigjent i Korit dhe i Orkestrës së Teatrit të Dubrovnikut. Nga viti 1945 ishte drejtor i Teatrit Popullor në Zarë. Ishte themelues i Korit e Orkestrës së Teatrit në Zarë,



SHIME DESHPALI


mësimdhënës (flaut, kornë, violë, vilonçel) në shkollën e atjeshme të muzikës dhe udhëheqës i korit të shkollës. Në krijimtarinë muzikore është mbështetur tek elementet e folklorit kombëtar. Ka përpunuar dhe kompozuar këngë korale (“Lenës”, “Lulëzoi lulja”, “Dashnor t’u bana”, “O moj ky Mehmeti”, “Valle”, “Moj Shajë”, “Vdekja e Larës” etj.), këngë për pionierë (“Neta”, “Zogu”, “Nxënësi i rregullt”, “Knoni”, “Qepësja e vogël”, “Kënga bareshe”, botuar më 1975), romanca për zë e piano (“Nina nana”, “Ndesha” dhe “Funtoma”), pjesë pianistike (“Dansi i Lulëzës”) dhe orkestrale (“Vallja e Pashkëve”, “Upria”). E paktër ka mbetur opera “Vana”. Nga letërsia ka botuar përmbledhjet “Tregime arbnore” (1966), “Agimet dhe parambramjet e Arbëneshit” (1969) dhe “E vërteta” (1972). (Zeqirja Ballata)

DESHPALI Valter (Dešpalj) (1947-). Violonçelist dhe pedagog i Arbëneshit të Zarës. Lindi në Zarë, vëllai i Palit dhe i Majës, i biri i Shime Deshpalit. Studioi në Baltimor dhe në Nju-Jork të SHBA-së, u diplomua në Juilliard School, u specializua në Konservatorin e Moskës. Në Zagreb mori gradën e magjistratit dhe filloi veprimtarinë koncertale. U bë i njohur jo vetëm në Kroaci, por gjithandej si artist përmasash ndërkombëtare me pjesëmarrje e suksese në qendra të Europës, Azisë, Australisë, SHBA-së, duke incizuar një varg disqesh dhe CD. Me repertor të gjerë të literaturës së pasur botërore për violonçel dallohet për teknikë virtuozë, muzikalitet, tingull të pastër dhe temperament. Nga viti 1972 vazhdoi karrierën prej pedagogu të violonçelit në Akademinë e Muzikës në Zagreb, duke promovuar violonçelistë të rinj nga Kroacia dhe nga vendet e tjera. (Zeqirja Ballata)

DESHPALI-BEGOVIQ Maja (1942-). Violiniste e Arbëneshit të Zarës. Lindi në Blato të Korçullës, motër e Palit dhe Valterit, bijë e Shime Deshpalit. U diplomua më 1967 në Akademinë e Muzikës në Zagreb, koncertmjeshtre e Orkestrës së Operës të Teatrit Popullor Kroat të Zagrebit, u specializua në Baltimor të SHBA-së. Organizoi koncerte e recitale në ish-Jugosllavi, Spanjë, SHBA, në ish-Bashkimin Sovjetik etj. Mori pjesë në shumë ansamble

kamerale në vend dhe jashtë, si dhe ka incizuar në shumë shtëpi radiotelevizive, ka realizuar disqe gramafoni dhe CD. (Zeqirja Ballata)

DEVA Agim (1948-2009). Shkrimtar, studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Beograd. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, ku kreu dhe studimet për gjuhë dhe



AGIM DEVA

letërsi shqipe. Më pas kreu studimet pasuniversitare dhe u doktorua në fushën e letërsisë për fëmijë. Një kohë punoi si gazetar në revistën “Zëri i rinisë”, më pas ishte kryeredaktor në “Gazetën e pionierëve”, ndërkaq në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës ligjëroi letërsinë për fëmijë. Ishte themelues dhe udhëheqës shumëvjeçar i Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë, i cili pas vdekjes mori emrin e tij. Është poeti më prodhimtar dhe njëri ndër studiuesit më të njohur të letërsisë sonë për fëmijë. Poezia e tij për fëmijë, si edhe ajo për të rritur, është një protestë e fuqishme ndaj së keqes, e cila reflektohet edhe në shpirtin e fëmijës. Botoi studimet monografike për romanin dhe për poezinë shqipe për fëmijë: “Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980” (1982), “Romani ynë për fëmijë (1977)”, si dhe një numër të madh të recensioneve dhe artikujve për letërsinë për fëmijë. U preventua në shumë antologji dhe panorama të poezisë për fëmijë. Shkroi edhe poezi për të rritur. U nderua me një sërë çmimesh letrare. Ndër veprat e botuara spikatin: “Trumbeta e artë” 1968, “Kali ynë lazdran” (1971), “Merrja lojës vetëm zemrën” (1975), “Rrota e historisë” (1981), “Kur qan e qesh Majliza” (1985), “Po ma vjedh dikush qytetin” (1994), “Xhela me një rrotë” (1998), “Guri rrokulliset përpjetë” (1999), “Koha e luleve” (2000), “Shtatë mrekullitë e mia” (2004), “Këtu dikush ka qenë” (2005), “Shitet babi im” (2006), “Gurët fluturues” (2007) etj. Hartoi tekste shkollore dhe përktheu poetë të njohur të letërsisë botrore dhe jugosllave. (Xhevat Sylja)


DEVA Naxhije (1927-2013). Aktore, regjisore, dramaturge. Lindi në Mitrovicë. Në vitet ’50 ndoqi kursin njëvjeçar për regji teatri. Studimet për art dramatik i ndoqi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më pas kreu



NAXHIJE DEVA

studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Ishte regjisorja e parë kosovare. Në fillim të karrierës teatrore luajti disa role në Teatrin e Mitrovicës: “Të vdekunit nuk paguejnë tatim”, “Koprraci”, “Zullumqari”, “Vocrraku im”, “Loja e rastit dhe e dashunisë”, “Nuk martohem me parë”, “Mblesëria”, “Zhorzh Dandeni”, “Bashkëshortët” etj. Në këtë teatër, si regjisore, ka vënë në skenë shfaqjet: “Nita”, “Halit Gashi”, “Miu në xhep”, “Doktor pa dashje”, “Bota”, “Besë” etj. Nga viti 1961 punoi si aktore në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë. Në këtë teatër, ku më vonë punoi edhe si dramaturge, luajti në një numër shfaqjesh si: “Autobiografia”, “Peripetitë e kohës”, “Zonja me kamelië”, “Dje mbasditë”, “I ndjeri”, “Nuk martohem me parë”, “Ruaje fshehtësinë time”, “Erveheja”, “Othello”, “Duart e papastra”, “Halili dhe Hajrija”, “Njeriu i mirë nga Seçuani”, “Makbethi”, “Tango”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Dasma e përgjakur”, “Kryet e hudrës”, “Varka e Noes”. Në vitin 2009, nga Ministria e Kulturës dhe Teatri Kombëtar i Kosovës u nderua me Çmimin Vjetor për Teatër. (Bekim Lumi)

DEVA Veli (1923-2015). Luftëtar i lëvizjes antifashiste nacionalçlirimtare, funksionar i lartë politik i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillore e kreu në



VELI DEVA

Gjakovë, ndërsa gjimnazin në Shkodër. U përfshi në grupet komuniste në Shqipëri gjatë periudhës 1941-1943. Pas kthimit në Kosovë, mori pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare. Pas luftës kreu shkollën politike në Beograd, ndërsa studimet për ekonomi i përfundoi në Shkup. Në vitin 1963 u zgjodh anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, më pas bëhet anëtar i Kuvendit Federativ (1965-1969) dhe anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë në vitin 1971. Paralelisht kreu edhe funksione partiake, përfshirë edhe funksionin e kryetarit të Komitetit Krahinor (KK) të Lidhjes Komuniste (LK) të Kosovës (1965). Pas Plenumit të Brionëve në vitin 1966 zhvilloi aktivitet të dëndur politik, veçmas në

fushën e ekonomisë. Pas vitit 1971 u emërua drejtor gjeneral i “Trepçës”, ku kontribuoi për ngritjen e kapaciteteve industriale në kuadër të këtij kombinati, përfshirë edhe disa fabrika të veçanta në qytete të ndryshme të Kosovës. Pas demonstratave të vitit 1981 zëvendësoi Mahmut Bakallin në postin e kryetarit të KK të LK të Kosovës. U largua nga skena politike e Kosovës me zhvillimet në fillim të viteve ‘90. (Kosovar Basha)

DEVA Xhafer (1904-1978). Politikan nacionalist, anëtar i qeverisë së Shqipërisë në periudhën e pushtimit gjerman. Lindi në Mitrovicë. U shkollua në Selanik, Stamboll dhe në



XHAFER DEVA

Vjenë, ku u diplomua për inxhinier. Mbas kapitullimit të Mbretërisë Jugosllave (1941), u angazhua për organizimin e pushtetit në rajonin Mitrovicë-Podujevë-Vushtrri-Novipazar, zonë që ishte nën pushtimin gjerman. Konsiderohet ideatori kryesor i themelimit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Më 1944 u emërua ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e Rexhep Mitrovicës. Zbatoi politikë të ashpër ndaj komunistëve dhe iu atribuua roli kryesor në masakrën e 4 shkurtit 1944 në Tiranë. Nga gjysma e dytë të vitit 1944 dhe deri në nëntor të po atij viti ishte kryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, duke u bërë njëri nga mbështetësit kryesorë të mbetjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në kuadër të Shqipërisë. Pas luftës emigroi në Austri, më 1947 në Itali dhe nga fundi i atij viti në Damask. Më 1948 në Damask botoi buletin “Bashkim i Kombit”, organ i parë i nacionalizmit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore. Më 1956 emigroi në Nju-Jork, më vonë në Boston, kurse më 1960 në Kaliforni. Atje organizoi emigracionin shqiptar, sidomos atë nga Kosova. Më 1966 u vu në krye të Lidhjes së Dytë të Prizrenit në Mërgim, me seli në Nju-Jork, organizatë që propagandoi çlirimin e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Vdiq në SHBA. (Muhamet Shatri)

DEVAJA Kurtesh (1947-). Gazetar. Lindi në Gjilan, ku mbaroi shkollimin filloresh dhe të mesëm, ndërsa studioi për filozofi në Shkup.

Fillimisht punoi në gazetën “Flaka e vël-lazërimit” në Shkup, pastaj në Radiotelevizionin e Prishtinës dhe Radiotelevizionin e Kro-acisë (korrespondent nga Kosova). Pas luftës ka qenë këshilltar dhe zëdhënës i Ministrisë së Komunikacionit të Kosovës (2002-2005) dhe njëkohësisht punoi si redaktor në Radiotelevizionin e Kosovës. Është autor i një sërë librash publicistikë: “Shtetësia e Kosovës” (1995), “Me shqiptarët e Anadollit” (2005), “Holokausti shqiptar” (2005), “Fryma atdhetare e shqiptarëve të Rumanisë” (2010), “Te Molla e Kuqe” (2013), pastaj i librit mësimor “Elementet bazë të gazetarisë: njohuri të përgjithshme për mediet e shkruara dhe elektronike (2010)” etj. (Ibrahim Berisha)

DEVAJA Mexhit (1948-). Punëtor sportiv. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Gjilan, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, dega e matematikës. Pas pavarësimit të hendbollit kosovar, ishte anëtar i këshillit drejtues të Federatës së Hendbollit të Kosovës, nënkryetar dhe më pas edhe kryetar për gati dy dekada. Dha kontribut në ndërkombëtarizimin e hendbollit kosovar. Ishte anëtar i Komitetit Olimpik të Kosovës në dy mandate e më pas edhe nënkryetar i këtij komiteti. Është kryetar nderi i Federatës së Hendbollit të Kosovës. Disa herë u shpall punëtor i dalluar sportiv. Për meritat në afirmimin e sportit u nderua me mirënjohje të shumta dhe dekorata. (Enver Sadiku)

DEVA-NURA Melihate (1925-2017). Veterane e arsimit. Lindi në Mitrovicë, ku kreu edhe shkollën fillore dhe atë zejtare për femra. Kreu edhe kursin pedagogjik në Prishtinë (1942). Ndërkohë, u emërua mësuese në shkollën fillore “Skënderbeg” në Mitrovicë. U shqua edhe për aktivitete të tjera jashtëmësimore. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte mësuese në Gjakovë, por për shkaqe politike u burgos dhe u dënua. Pas lirimit nga burgu, punoi si mësuese e punëtoresh në shkollën e amvisërisë në Gjilan, ndërsa nga viti 1958 ishte edukatore në foshnjoren e qytetit të Prishtinës. Për merita të veçanta për shkollën dhe arsimin shqip u nderua me mirënjohje dhe dekorata. (Afërdita Kumnova-Mulla)

DEVA-ZUNA Afërdita (1950-). Pedagoge, profesore universiteti. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në



AFËRDITA
DEVA-ZUNA

Prishtinë. Studioi shkencat pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, magjistroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa doktoroi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Në vitin 1973 filloi punën e mësime-

hënës në gjimnazin e Prishtinës, ndërsa në vitin 1977 u zgjodh asistente për disa lëndë në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në vitet vijuese u gradua në të gjithë titujt universitarë. Ligjëroi lëndët pedagogji dhe pedagogji familjare, menaxhim i klasës etj. U angazhua edhe në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Punoi, gjithashtu, edhe në Universitetin e Tetovës. Ushtri edhe disa funksione profesionale, mori pjesë në programe aftësimi në vend dhe në botën e jashtme. Fushë e interesimit të saj kërkimor-shkencor janë pedagogjia familjare dhe pedagogjia parashkollore. Botoi një sërë artikujsh shkencorë dhe është autore dhe bashkautore e disa veprave pedagogjike dhe e teksteve universitare: “Edukimi i parashkollorit në familje” (2003), “Dhuna në familje nën thjerrën pedagogjike” (2008), “Standardet e arsimit dhe edukimit parashkollor në Kosovë /3-6 vjeç” (2006), “Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë /3-6 vjeç” (2006), “Partneriteti shkollë-familje-komunitet” (2009) etj. (Hajrullah Koliqi)

DEVETAKU Ymer (1881-1946). Luftëtar i lëvizjes kombëtare që nga periudha osmane e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Lindi në fshatin Devetak të Komunës së Shtimes. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Ferizajt më 1908, pastaj në luftën e Shtimes (1910). Pas Luftës së Parë Botërore bashkëpunoi me Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Më 1918, pas sulmit nga xhandarmëria serbe në shtëpinë e tij (1919), formon çetën çlirimtare kaçake, me rreth 40 luftëtarë. Çeta e tij, së bashku me atë të Adem Reçakut, kryen disa aksione të armatosura kundër xhandarmërisë serbe. Gjatë një aksioni të tillë u zu rob dhe u burgos në Ferizaj (1923). Pasi u arratis nga burgu, kaloi në Shqipëri dhe u vendos në Fushë-Krujë (1923-1941). Pas zhbërjes së Jugosllavisë më 1941, kthehet në Kosovë dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore u përfshi në lëvizje kundër

komunistëve. Mori pjesë në shumë aksione të armatosura kundër partizanëve dhe më 1945 plagoset. Pasi u rrethua nga forcat e OZN-ës, për të mos u dorëzuar, bëri vetëvrasje. (Skënder Lutfiu).

DEVSHIRMEJA. Praktikë institucionale osmane e rekrutimit të djemve të krishterë, me qëllim të edukimit dhe aftësimit të tyre për të shërbyer brenda dhe jashtë pallatit sulltanor (saraj) dhe në repartin e jeniçerëve. Fillimisht për këto shërbime rekrutoheshin djemtë e zënë robër, të cilët edukoheshin dhe aftësoheshin në repartin e *axhemive*, i cili u themelua në kohën e Muratit I në vitin 1363. Institucioni i devshirmesë funksionoi në bazë të një ligji të veçantë, që u nxor në fillim të mbretërimit të Muratit II (1421-1451). Mbledhja e devshirëve bëhej me vendim të këshillit shtetëror (Divan), sipas nevojës, një herë në 3, 5 ose 7 vjet. Mosha e djemve të rekrutuar sillej nga 8-20 vjeç. Përgjegjësi kryesorë për mbledhjen e tyre ka qenë agai i jeniçerëve dhe agai i repartit të *axhemive*. Ata kishin me veti sekretarin, i cili regjistronte secilin devshir. Sipas rregullave, nuk janë marrë devshirë djemtë nga qyteti, djemtë e vetëm të familjes, zanatlinjtë dhe djemtë e martuar. Devshirët më të shkathtë fizikisht, me gjatësi mesatare, i ndanin për në repartin e jeniçerëve, ndërsa ata më të zgjuarit, më të sjellshmit, më të pashmit dhe më të gjatët i ndanin për saraj, ku arsimoheshin dhe edukoheshin në shkollën speciale të quajtur *Enderun*, së bashku me djemtë e sulltanëve dhe përgatiteshin për punë dhe shërbime të ndryshme shtetërore. Pjesa më e madhe e devshirëve shqiptarë, të cilët u dalluan si qeveritarë të lartë, poetë, kaligrafë, historianë, muzikantë etj., kanë dalë pikërisht nga kjo shkollë. Devshirët në Rumeli, kryesisht janë rekrutuar nga radhët e shqiptarëve, bullgarëve dhe boshnjakëve. Në viset shqiptare janë marrë devshirë më së shumti nga rrethina e Shkupit, e Prizrenit, e Korçës, Tashlixhës, Gjirokastrës, Janinës, Përlepit, Shtipit, Shkodrës, Ohrit, Pejës, Manastirit, Prespës, Hurpishtës, Bilishtit etj. Praktika e devshirmesë ka vazhduar deri në kohën e Ahmetit II (1691-1695). (Nehat Krasniqi)

DËBIMI I SHQIPTARËVE TË KOSOVËS NGA SERBIA (1998-1999). Dëbim i dhunshëm i shqiptarëve të Kosovës nga forcat



EKSODI I SHQIPTARËVE TË KOSOVËS MË 1999

ushtarake dhe policore të Serbisë gjatë luftës së fundit, me synim për ta ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës. Dëbimi i banorëve nga zonat e luftës u zhvillua që në operacionet e para të ushtrisë dhe policisë serbe ndaj fshatrave shqiptare. Vrasjet e civilëve, granatimet, djegiet e shtëpive, shkatërrimi i ekonomive familjare shoqëronin çdo ofensivë të forcave serbe. Gjatë vitit 1998 u bë dëbimi i parë për në Shqipëri i banorëve nga zonat kufitare dhe nga disa fshatra të Dukagjinit. Por me fillimin e bombardimeve të NATO-s dëbimi u zhvillua me shpejtësi të madhe dhe me një strategji të parapërgatitur. Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), brenda tri javësh nga fillimi i bombardimit të NATO-s, në vendet fqinje me Kosovën mbërritën 525,787 refugjatë. Ndërsa në tërësi forcat e ushtrisë dhe të policisë së Serbisë dëbuan nga Kosova 862,979 shqiptarë. Qindra e mijëra të tjerë ishin të zhvendosur brenda territorit të Kosovës, pa përfshirë këtu të zhvendosurit para marsit të vitit 1999. Llogaritej se mbi 80% e popullsisë së Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit të dhjetorit 1999 ishte vlerësuar se numri i përgjithshëm i të dëbuarve shqiptarë të Kosovës dhe i personave të detyruar që largoheshin nga shtëpitë e tyre ishte 1.5 milionë, ose mbi 90% e shqiptarëve të Kosovës.

Vrasjet masive të shqiptarëve kishin filluar para operacioneve luftarake, kurse gjatë

bombardimeve të NATO-s ato u intensifikuan. Për të fshehur krimet, një numër të vlarësh u bartën dhe u varrosën nëpër varreza masive në Serbi. Dëbimi i dhunshëm i popullsisë civile ishte i organizuar dhe i koordinuar mirë, sipas planit të koduar "Patkoi". Ushtria serbe kontrollonte rrugët dhe kufijtë, ndërkaq policia dhe paramilitarët futeshin nëpër fshatra ose nëpër lagje, nxirrnin njerëzit nga shtëpitë, ndanin burrat nga gratë e fëmijët, i plaçkitnin dhe në disa raste i ekzekutonin. Nga qytetet e mëdha popullsia u dëbua, duke përdorur autobusë, trena dhe mjete të tjera të transportit, për t'u bartur deri te kufiri i Shqipërisë ose i Maqedonisë. Veturave dhe traktorëve ua hiqnin targa dhe të gjitha dokumentet përcjellëse, ndërsa personave u merreshin letërnjoftimet, pasaportat, certifikatat e lindjes, dokumentet e kurorëzimit dhe çfarëdo dokumenti tjetër, duke synuar zhdukjen e çdo lidhjeje të tyre faktike dhe juridike me vendin e tyre, me qëllim të pamundësimit të kthimit në Kosovë. Kosovarët e dëbuar në Shqipëri dhe në Maqedoni u vendosën në kampe të shumta, në vendstrehime të përkohshme dhe nëpër shtëpi private. Një numër syresh u transferuan në vende të treta, me qëllim të lehtësimit të gjendjes humanitare në këto dy shtete. Vendosja e refugjatëve sipas shteteve ishte: 443,300 në Shqipëri, 247,800 në Maqedoni, 69,300 në Mal të Zi, 21,700 në Bosnjë e Hercegovinë, pra gjithsej 782,100 veta. Në vendet e tjera të botës u vendosën 76,475 refugjatë, duke përfshirë 13,639 në Gjermani, 7,581 në Turqi, 5,829 në Itali, 5,730 në SHBA, pastaj në Francë, Norvegji, Suedi, Britani të Madhe, Poloni, Spanjë, Portugali, Finlandë, Zvicër, Australi, Izrael etj. (Sylë Ukshini)

DËMET E LUFTËS. Dëmet që shkaktoi Serbia në Kosovë gjatë luftës së fundit, më 1998 dhe 1999. Përveç vrasjeve, dhunimeve, plaçkitjes, shpërnguljes me dhunë dhe keqtrajtimit të formave të ndryshme, Serbia, me anë të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve plaçkiti dhe shkatërroi në masë të madhe pronat dhe pasurinë e shqiptarëve të Kosovës. Ndër zonat më të shkatërruara gjatë luftës konsiderohen zona e Drenicës dhe e Dukagjinit, por edhe zonat e tjera. Në total, dëmet e shkaktuara nga Serbia kapin 100,589 shtëpi të shkatërruara ose të dëmtuara, 358 shkolla, 71 zyra ofiqarie, 30 shtëpi kulture, 93 biblioteka publike dhe shkollore, 123 objekte shëndetësore, 215



SHKATËRRIMET E OBJEKTEVE CIVILE GJATË LUFTËS NË KOSOVË

objekte fetare (xhami, teqe, tyrbe), 5 kisha katolike, 88,101 objekte ndihmëse-përcjellëse. Vlerësohet se gjatë viteve 1997-1999 Serbia shkatërroi mbi 2,700 objekte me vlerë kulturore e arkeologjike. Në të vërtetë, dëmtimi dhe plaçkitja e bazës ekonomike të Kosovës nga Serbia filloi qysh në periudhën e rrënimit institucional dhe suprimimit me dhunë të autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989. Rëndom shqiptarët plaçkiteshin para se të dëboheshin, apo edhe gjatë rrugës. Ata që kundërshtonin, kërcënoheshin me vdekje, ose u merreshin peng gratë dhe fëmijët, derisa ata të mos dorëzonin paratë dhe çdo gjë të vlefshme. Dëmet dhe shkatërrimet më të mëdha të luftës në Kosovë i pësuan ekonomitë familjare. Dëmet më të mëdha pësuan edhe ndërmarrjet publike, mjetet e punës, teknologjia, makinat dhe çdo gjë tjetër e lëvizshme. Në bankat e Kosovës u grabitën depozitat e shqiptarëve dhe të kompanive publike, sikundër edhe fondi i pensioneve. Vetëm gjatë periudhës 1998-1999 në Kosovë konsiderohet se janë vlarë rreth 14,000 persona dhe rreth 1 milion shqiptarë u dëbuan me dhunë nga Kosova, me mijëra vetë u burgosën, kurse numri i grave të dhunuara arrin në 20,000. Gjatë viteve 1998 dhe 1999 policia dhe ushtria serbe ndoti në mënyrë sistematike puset, depozitat dhe burimet e tjera të ujit. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), vlerësohet se nga 20 mijë puse të Kosovës, më shumë se gjysma u ndotën në

forma të ndryshme. Vlerësimi preliminar i organizatave vendore dhe ndërkombëtare të dëmeve që i ka shkaktuar Serbia në Kosovë llogaritet deri në 15 miliardë euro. (Sylë Ukshini)

DËRGUTI Ahmet (1951-). Bariton. Lindi në Brainë të Podujevës. Në Prishtinë kreu Shkollën e Mesme të Muzikës, u diplomua në Akademinë e Muzikës në Sarajevë për solokëndim



AHMET DËRGUTI

(1975) dhe u specializua për solokëndim dhe regji operistike (1980/82) në Bukruesht. Kreu studimet pasuniversitare në drejtimin operistik në Beograd (1987). Nga viti 1976 punoi në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë dhe në Gjilan. Më 1984 u zgjodh asistent në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe më pas në Universitetin e Tetovës. Gjatë studimeve këndoi në Korin e Operës në Sarajevë. Gjatë specializimit pati role në operat e Mozartit, Puçinit, Verdit etj. Me korin e Radiotelevizionit të Prishtinës këndoi si solist në vitet 1986-1989. Në operën “Dasma arbëreshe” të R. Dhomit luajti rolin e kalorësit. Dha koncerte solistike në Prishtinë, Beograd, Novi-Sad, Zagreb, në Weinkersheim (Gjermani) si solist në operën “Fidelio” të Bethovenit. Mori pjesë në festivale e tribuna muzikore në Prishtinë, Opati, Herceg-Novit. Ishte prodekan dhe dekan i Fakultetit të Arteve (2006-2009) dhe kryetar i Shoqatës së Artistëve Muzikorë të Kosovës. Është profesor ordinar i solokëndimit me metodikë në UP. (Indira Çipa)

DËRGUTI Mustafë (1897-1945). Veprimtar antikomunist, deputet në parlamentin e Mbretërisë së Jugosllavisë në dy mandate (1933-37 dhe 1938-41). Lindi në Rahovec. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Në rini u mor me tregti. Pas zgjedhjes deputet në Parlamentin e Jugosllavisë, mbajti kontakte me personalitete të shquara, si: Ferhat Draga, Ramë Bllaca, Ibrahim Lutfiu etj. I takonte grupit të “Xhemietit”, të cilët në Kuvendin e Shkupit, në tetor 1938, kundërshtuan marrëveshjen jugosllave-turke për shpërnguljen e shqiptarëve. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u mor me tregti dhe politikisht u angazhua në krahun e forcave antikomuniste.

Për shkak të aktivitetit antikomunist arrestohet në fund të vitit 1944. Arrin të ikë nga burgu, por denoncohet, rrethohet nga forcat ushtarake-policore dhe vritet gjatë rezistencës. (Liman Rushiti).

DËRMAKU Adem (1978 -). Grafist. Lindi në Gjilan. Kreu Fakultetin e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës, në Prishtinë (2002). Në vitet 1999-2014 mori pjesë në disa ekspozita në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni Rumani, Bullgari, Zvicër, Austri, Gjermani, Francë, Spanjë dhe Japoni. Organizoi disa ekspozita personale, si në Galerinë “Am Lindenhof” në Cyrih (2014), pastaj në “Kulturschüür liebegg Männeorf” në Cyrih (2013) dhe më herët në Galerinë “Wolfensberger” po në Cyrih (2010), në Galerinë e Arteve të Kosovës (2010), në Art Klubin Alternativ në Shkup (2003), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2003) etj. Është fitues i disa çmimeve. Nga viti 2003 jeton dhe punon si asistent i litografisë në studion Steindruckerei Wolfensberger në Cyrih të Zvicrës. (Basri Mekolli)

DËRMAKU Fatmir (1975-). Grafist. Lindi në Shipashnicë të Epërme të Kamenicës. Kreu arsimin fillor në vendlindje, Shkollën e Mesmen të Artit në Pejë, ndërsa studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2000). Grafikat e tij realizohen kryesisht me akuatintë dhe bakërskrim, me gravurim teknikisht të përkryer, të ekzekutuar në dy pllaka shumëngjyrëshe me struktura të pasura dhe përmbajtësore. Temat e tij të preferuara janë torzot dhe kompozicionet abstrakte. Ka ekspozuar në Galerinë “Filippe Auguste” në Vernon të Francës dhe merr pjesë rregullisht në disa ekspozita kolektive, si Salloni i Nëntorit (1996-2004), në manifestimin kulturor “Flaka e Janarit” në Gjilan (1996-2006) etj., si dhe në disa koloni artistike. (Fatmir Krypa)

DËRMAKU Hilmi (1941-). Kimist, teknolog. Lindi në Shipashnicë të Epërme të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Hogosht, ndërsa të mesmen në Prishtinë, ku kreu edhe kiminë në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës (1969). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Teknologjisë në Zagreb (1971). Nga viti 1971 punoi në Fabrikën e pllakave të qeramikës “Karaçeva” të Kamenicës, si shefi i prodhimit


dhe drejtor teknik. Në këtë kohë specializoi në disa firma në fushën e prodhimit të ngjyrave, në Firencë e Perugja të Italisë dhe në Këln të Gjermanisë. Në cilësinë e këshilltarit apo të udhëheqësit të prodhimit punoi në shumë vende të botës, në disa vende të Amerikës Latine, pastaj në Nigeri, në Algjeri, Rusi, Shqipëri, Siri, Turqi dhe Egjipt. (Fejzullah Krasniqi)

DËRMAKU Ismet (1927-). Historian, profesor universiteti. Lindi në fshatin Shipashnicë të komunës së Kamenicës. Shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje, ndërsa mësimet i ndoqi në Shkollën Normale të Prishtinës dhe në Gjakovë. Studioi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Beograd dhe në Fakultetin Filozofik të Shkupit, ku u diplomua për histori (1959). U specializua në lëndët historike dhe arkivistikë në Moskë, Bukuresht, Tiranë etj., dhe më pas u doktorua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Nga viti 1963-1977 ishte drejtor i Arkivit Krahinor të Kosovës dhe themelues dhe kryeredaktor i revistës “Vjetari i Arkivit të Kosovës” (1966-1986). U mor me riorganizimin e shërbimit arkivor të Kosovës. Ishte njëkohësisht profesor në degën e historisë në UP. Në fushën e studimeve historike dha kontribut në mbledhjen dhe botimin e dokumenteve për periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Botoi monografitë: “Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare të Rumanisë dhe Bullgarisë” (1983, 1987), “Gazeta ‘Vetëtim’a dhe veprimtaria e saj patriotike dhe popullore” (1983), “Gjon Sereqi dhe Lëvizja Nacionaldemokratike Shqiptare (NDSH) (dokumente arkivore)” (1996), “Nikolla Naço Korça, apostull i shqiptarizms (1843-1913)” (2000), “Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Pejës ‘Besa Besë’ 1899 (dokumente)” (1997), “Shoqëria e mësimit shqip ‘Drita’ e Bukureshtit në zgjimin dhe çlirimin kombëtar (1884-1914) sipas dokumenteve më të reja arkivore” (2009); “Promemoret e Nikolla Naços dhe vllhtë e Maqedonisë” (2013). Botoi një varg punimesh shkencore dhe dokumentesh në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Fitim Rifati)

DËRVISHAJ Bujar (1965-). Trajner i volejbollit. Lindi në Prishtinë. Nisi karrierën si volejbollist në “Universitetin” e Prishtinës. Më pas kaloi në KV “Elektroekonomia” të Obiliqit.

Pastaj luajti për “Spartakun” e Suboticës, për të vazhduar në Gjermani, ku pos si lojtar në shumë skuadra kreu edhe punën e trajnerit. Në vitin 2007 zhvendoset në Zvicër, ku vazhdon punën e trajnerit, duke u pajisur me licencën profesionale. Gjatë periudhës 2007-2015 ishte drejtues i shkollës së talenteve në Aargau të Zvicrës. Në të njëjtën kohë ishte në shtabin teknik të trajnerëve të përfaqësueses së Zvicrës në konkurrencën e të rinjve, (2010/13), ndërsa dy vjet më vonë u emërua kryetrajner i përfaqësueses së Zvicrës në konkurrencën e të rinjve. (Xhavit Kajtazi)

DËRVISHI Teki (1943-2011). Poet, prozator, dramaturg dhe publicist. Lindi në Gjakovë, ku kreu edhe shkollën fillore, të mesmen e mbaroi në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Për shkaqe politike në moshën 17-vjeçare u burgos dhe u dënua me tri vjet burg, të cilat i vaujti në burgun famëkeq jugosllav të Goli Otokut. Një kohë ishte mësimdhënës në disa fshatra të Rahovecit, ndërsa për dhjetë vjet (1971-1981) ishte gazetar i rubrikës së kulturës në gazetën “Flaka e vëllazërimit” në Shkup. Që në rini iu përkushtua letërsisë dhe publicistikës. Një kohë ishte korrektor i botimeve të “Rilindja”. U pensionua si drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës. Deri në ditët e fundit të jetës ishte redaktor i gazetës “Bota sot”. T. Dërvishi botoi vepra letrare të të gjitha zhanreve, ishte përkthyes dhe u përfshi në disa antologji të poezisë brenda dhe jashtë vendit. Botoi këta libra poetikë: “Nimfa” (1970), “I varur për vargje për drurin e blertë” (1971), “Shtëpia e sëmurë” (1978), “Thashë” (1981); romanet: “Pirgu i lartë” (1972), “Padrona” (1975), “Skedarët” (1974), “Herezia e Dërvish Mallutës” (1982), “Palimpsest për Dush Kusarin” (1993), pastaj librin me tregime “Etje dhe borë” (1972) etj. U dallua edhe si autor i dramave: “Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi” (1979), “Bregu i Pikëllimit” (1985), “Pranvera e librave” (1990), “Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit” (1990), “Kufiri me atdhe” (1996), “Vojceku” (1996), “Eshtrat që kthehen vonë” (2000), “Nesër nisemi për Parajsë” (1999), “Ku është



TEKI DËRVISHI

populli?” (2003). Shkroi e botoi edhe kritika dhe ese për teatrin, të përmbledhura në librin “Qan e qesh Talia” (1978). Ndërkohë, poezitë e tij janë cilësuar si vijimësi e frymës moderne me shenja simbolike dhe simboliste, ndërsa proza si kërkim dhe shpalim i psikologjisë së individit. Shumë nga dramet e tij u inskenuan në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Vepra letrare e T. Dërvishit mbart elemente të përbashkëta estetike të një brezi shkrimtarësh, të cilët u formuan dhe u dalluan kryesisht në vitet ’70 të shekullit të kaluar. (Agron Gashi)

DËSHMORËT E FAMILJES LLESHI. Familje e katër dëshmorëve (Marku, Preni, Kola dhe Mema), të cilët bënë emër në betejën e janarit të vitit 1999 në Goden të Gjakovës. Beteja e Vraniqit u zhvillua më 7 gusht 1998, kur familja Lleshi u rrethua nga forcat ushtarake dhe policore serbe. Në luftime për thyerjen e rrethimit u përfshinë vëllezërit Gega, Nika, Mema, Toma, si dhe prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Pas tri orë luftimesh, luftëtarët e familjes Lleshi arritën t’i thyejnë tri rrethime të ushtrisë dhe policisë serbe. Gjatë këtyre luftimeve ranë dëshmorë Kolë Gjon Lleshi (1967) dhe Mark Tunë Lleshi (1926), kurse pjesa tjetër e familjes arriti të largohet nga fshati dhe u vendos në Dabidol të Rahovecit. Rezitenca e kësaj familjeje pati jehonë dhe ndikoi në zgjerimin e luftës në Kosovë. Më pas anëtarët e familjes Lleshi vepruan në kuadër të Zonës Operative të Dukagjinit (ZOD) dhe të Pashtrikut, duke marrë pjesë në aksione luftarake dhe beteja. Pas ofensivës së shtatorit të vitit 1998, vëllezërit Lleshi ishin ndër luftëtarët e UÇK-së që iu bashkuan komandantit të ZOD-it në Jabllanicë të Dushkajës. Drejtuan edhe njësitin e furnizimit në nivel të ZOD-it, duke bërë dhjetëra rrugë për furnizim me armatim për në Shqipëri dhe anasjelltas. Në betejën e përgjakshme të 27, 28 e 29 janarit 1999, bashkë me 19 bashkëluftëtarë të tjerë dhe 9 civilë të fshatit Rogovë e Hasit, ranë dëshmorë edhe vëllezërit Memë Zef Lleshi (1973) e Prend Zef Lleshi (1964). Për t’i nderuar dëshmorët e familjes Lleshi, në Kodrën e Vraniqit u ndërtua një lapidar. (Fetnete Ramosaj)

DI XHOVINE Paolo (Giovine) (1957-). Gjuhëtar, indoeuropianist. Është diplomuar më 1979 në Romë. Më 1987 u bë profesor i dialektologjisë në Universitetin e Bazilikatës.

Nga viti 1991 është profesor i gjuhësisë në Universitetin e Romës. Botoi libra dhe artikuj për probleme fonetike, fonologjike, morfologjike, leksikologjike dhe etimologjike në fushë të indoeuropianistikës (indishte, iraniste, greqishte, shqipe, gjermanishte) dhe të romanistikës. Botimet e tij me rëndësi që lidhen me shqipen janë: “Trakishtja, dakishtja e shqipja në perspektivën gjenealogjike” (Tracio, dacio ed albanese nella prospettiva genealogica, 1979); “Grupi CT i latinishtes në shqipen” (Il gruppo CT latino in albanese, 1982); “Studim mbi perfektin indoeuropian” (Studio sul perfetto indoeuropeo, I, II, III, 1990, 1996); “Gjuha shqipe midis botës latine dhe botës greke të lashtë në suidhesën ballkanike” (La lingua albanese tra mondo latino e mondo greco antico nella penisola balcanica, 1992); “Nga dukat te investitor: nëntë shekuj të italishtes në Shqipëri” (Dal dukat all’investitor: nove secoli di italiano in Albania, 2007); “Një mijëvjeçar historie gjuhësore shqipe: ndikimi leksikor i gjuhës italiane” (Un millennio di storia linguistica albanese: l’influsso lessicale della lingua italiana, 2008) etj. (Shpëtim Elezi)

DIALIZA. Metoda kryesore bashkëkohore për mjekimin e të sëmurëve me pamjaftueshmëri kronike të veshkave. Dializa përdoret te të sëmurët, të cilët kanë humbur funksionin pastrues të veshkave. Ka dy lloje dializash: jashtëtrupore (veshka artificiale) dhe trupore (peritoneale). Trajtimi i të sëmurëve me dializë në Kosovë ka filluar më 18 qershor të vitit 1978 në Klinikën Interne të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Kishte 10 makina të tipit Redy me gjithsej 25 pacientë dhe drejtohej nga prof. dr. Shefqet Berisha. Pas Prishtinës, në Kosovë hapen edhe qendrat të tjera të dializës: në Mitrovicë (1980), Prizren (1985), Gjilan (1986), Pejë (1990), Gjakovë (2003) dhe Ferizaj (2009). Në vitin 2009 në Klinikën e Nefrologjisë fillon në mënyrë të plotë trajtimi i pacientëve me dializë peritoneale. Kosova ka rreth 700 pacientë në program kronik të hemodializës (2015), një pacient në dializë peritoneale dhe rreth 120 pacientë me veshkë të transplantuara. Në vitin 2010 në Prishtinë hapet edhe një pilot qendër e dializës në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë. Në vitin 2014 shërbimi i dializës në Prishtinë u vendos në një qendër të re moderne, me sipërfaqe mbi 1,000 metra katrorë dhe me kapacitet prej 50 vendesh. Të

gjitha qendrat e dializës në Kosovë aktualisht disponojnë mbi 240 aparate moderne për hemodializë. Gjithashtu qendrat e dializave janë të furnizuara me material shpenzues të cilësisë më të lartë. Seanca zgjat 3-4 orë dhe bëhet tri herë në javë. (Ymer Elezi)

DIALOGU NDERFETAR NË KOSOVË. Formimi i Këshillit Ndërfetar në Kosovë në mes tri bashkësive fetare tradicionale, Bashkësisë Islame, Kishës Katolike dhe Kishës Ortodokse ka filluar me mbajtjen e konferencës së liderëve fetarë në Vjenë më 16-18 mars 1999, para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s. Mund të thuhet se kjo ishte përpjekja e fundit e liderëve fetarë për ta parandaluar gjakderdhjen dhe tmerret e luftës, të cilat e përfshinë tërë rajonin. Në konferencën e Vjenës tri bashkësitë fetare përfaqësoheshin nga këta tre liderë fetarë: Qemajl Morina, zëdhënës i Bashkësisë Islame të Kosovës, Mark Sopi, ipeshkëv i Kishës Katolike të Kosovës dhe Artemije Rdosavlevq, peshkop i Kishës Ortodokse Serbe. Ata iu drejtuan opinionit dhe besimtarëve me një apel, në të cilin kërkohej respektimi i të drejtave të të gjitha bashkësive në Kosovë, të gjykohej përdorimi i dhunës, urrejtja ndërnacionale dhe ndërfetare. Kjo konferencë ishte organizuar nga Rabai Artur Shnajer, kryetar e Organizatës “Apeli i ndërgjegjes” (Appeal of Consciousness), me seli në Nju-Jork. Konferenca e Vjenës u mbajt nën mbikëqyrjen e Presidencës Austriake. Ndërkaq, më 13 prill të vitit 2000 u themelua Këshilli Ndërfetar i Kosovës. Me këtë rast u nënshkrua një deklaratë e përbashkët ndërmjet përfaqësuesve më të lartë fetarë të Kosovës: Myftiut të Kosovës dr. Rexhep Bojës, Ipeshkëvit të Kosovës Mark Sopit dhe peshkopit të Kishës Ortodokse Serbe Artemije. Në ceremoninë e nënshkrimit të deklaratës mori pjesë edhe Bernard Kushner, administrator i UNMIK-ut. Kontribut të rëndësishëm në formimin e Këshillit Ndërfetar të Kosovës ka dhënë Konferenca Botërore Fetë për Paqe (World Conference Religions for Peace), e cila kishte venë kontaktet me bashkësitë fetare të Kosovës qysh në qershorin e vitit 1998. Formimi i Këshillit Ndërfetar bëri që ai të aktivizohet dhe të marrë pjesë në shumë takime të karakterit ndërfetar, siç është ai i Amanit në maj të vitit 2000, pastaj ai i Oslos në shtator të vitit 2001 etj. Shumica e takimeve fetare të asaj periudhe

u mbajtën në nivelin lokal mes përfaqësuesve të grupeve lokale, në kuadër të Këshillit Ndërfetar deri më 2003, falë angazhimit të organizatës “Fetë për paqe” dhe “Kishës Norvegjeze për Ndihma”, të cilat që në prill të vitit 2001 kishin hapur zyrën e tyre të përhershme në Kosovë, me qëllim të bashkimit të përpjekjeve për ta çuar përpara dialogun ndërfetar. Ishte marrë vendim që të zgjidheshin nga dy këshilltarë nga secili prijës fetar, që të formohej një grup ndërfetar prej gjashtë përfaqësuesish. Tre liderët fetarë u dhanë përkrahjen këtyre takimeve. Një numër i takimeve të tjera, me qëllim të vazhdimit të dialogut ndërfetar janë mbajtur deri në fund të vitit 2002. Në shkurt të vitit 2003 u mbajt takimi i fundit i grupit punues. Ndërkohë, në Kosovë është paralajmëruar themelimi i një Qendre Ndërkombëtare për Dialog Ndërfetar në vazhden e angazhimit të shtetit të Kosovës për ta promovuar tolerancën dhe dialogun ndërfetar (Qemajl Morina).

DIALOGU PËR ÇËSHTJE TEKNIKE KOSOVË - SERBI (2011-2012). Dialogu i inicuar dhe i lehtësuar nga Bashkimi Europian, që zyrtarisht është emërtuar “dialogu Beograd-Prishtinë”, synon gjetjen e zgjidhjeve praktike për çështje të ndryshme të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ndonëse Kosova nuk njihet nga Serbia. Takimi i parë i dialogut është mbajtur në mars të vitit 2011 në Bruksel. Takimet në kuadër të dialogut teknik kryesohen nga Robert Kuper në emër të Bashkimit Europian, me Edita Tahirin si kryesuese e delegacionit të Kosovës dhe Borko Stefanoviqin si kryesues i delegacionit të Serbisë. Marrëveshjet e para ndërmjet palëve janë arritur në qershor 2011 për lirinë e lëvizjes, regjistrin civil dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave. Gjatë takimeve vijuese janë negociuar dhe janë arritur marrëveshje për tema të ndryshme, si: regjistri kadastral, vulat doganore, liria e lëvizjes, njohja e ndërsjellë e diplomave universitare, regjistri civil, përfaqësimi rajonal dhe menaxhimi i integruar i kufirit. Paralelisht me negociatat për tema të reja, gjatë dialogut është trajtuar rregullisht shkalla e implementimit të marrëveshjeve të arritura. (Ilir Dugolli).

DIALOGU POLITIK KOSOVË-SERBI. Proces negociator ndërmjet krerëve të qeverive të Kosovës dhe të Serbisë, i inicuar dhe

i udhëhequr nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Europian për Politikë të Jashtme dhe Siguri në Bruksel. Zyrtarisht i trajtuar nga Bashkimi Europian si proces me karakter neutral ndaj statusit të Kosovës, dialogu është inicuar me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të eliminuar bllokimin e ndërsjellë në procesin e integritimit në Bashkim Europian. Ka filluar pas rezolutës së inicuar nga Serbia dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (shtator 2010), në të cilën merret në dijeni mendimi këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për pavarësinë e Kosovës dhe mirëpritet gatishmëria e Bashkimit Europian për të lehtësuar dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Bashkimi Europian ka insistuar në fillimin e këtij dialogu, duke u mbështetur në domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal, si një ndër kriteret e Kopenhagës për të gjitha vendet, të cilat kanë aspirata për t'u bërë pjesë e BE-së. Pas dhjetë raundeve të takimeve intensive, delegacioni i Kosovës i kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi dhe delegacioni i Serbisë, i kryesuar nga kryeministri Ivica Dačić, më 19 prill 2013 nënshkruan "Marrëveshjen e parë të parimeve udhëheqëse për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë". Një muaj më vonë (31 maj 2013) u arrit pajtimi ndërmjet palëve për planin e zbatimit të marrëveshjes, me të cilin janë detajuar aspektet e zbatimit të marrëveshjes dhe është caktuar komisioni që ka për mandat mbikëqyrjen e këtij procesi. Më 25 gusht 2015, në Bruksel, u arrit marrëveshja përfundimtare për të gjitha pikat e mbetura nga dialogu i Brukselit midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Marrëveshjen, me ndërmjetësimin e përfaqësueses për politikë të jashtme të BE-së, Federika Mogerini, në Bruksel e nënshkroi kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, dhe kryeministri i Republikës së Serbisë, Aleksandar Vučić. Kjo marrëveshje i siguronte Kosovës kodin telefonik, bashkëmenaxhimin e energjisë dhe të liqenit të Gazivodës, si dhe krijimin e asociacionit të komunave serbe.

Dialogu trajtohet si një proces i vazhdueshëm, përmes të cilit duhet të normalizohen marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, si parakusht që të dy shtetet të bëhen pjesë e BE-së. Nuk ka ndonjë kornizë kohore, ndonëse normalizimi kuptohet në mënyra të ndryshme nga

pjesëmarrësit. Mungon konsensusi, si ndërmjet palëve negociatore, ashtu edhe brenda radhëve të shteteve anëtare të BE-së, se cili do të duhej të ishte rezultati përfundimtar i dialogut. Përderisa nga shumica e shteteve perëndimore vlerësohet si proces i domosdoshëm, po ky proces shoqërohet me kritika të shumta nga opinioni i brendshëm në Kosovë dhe në Serbi. Në Kosovë procesi është kritikuar, para së gjithash, për mungesë transparence, për përfshirjen e Serbisë në vendimmarrje për çështje e brendshme të Kosovës dhe për shndërrimin e asociacionit të komunave serbe në pushtet më vete. Ka vlerësime kundërtënëse edhe për vetë shkallën e zbatimit të gjertanishëm të marrëveshjes, sikundër edhe për dobinë që ka sjellë dialogu i gjertanishëm i Kosovës me Serbinë. Megjithatë, me nuanca të ndryshme, pothuajse të gjitha partitë politike në Kosovë e pranojnë domosdoshmërinë e ndonjë forme të dialogut me Serbinë. Lëvizja "Vetëvendosje" është partia më e zëshme në Kosovë, me qëndrimin e saj kritik ndaj procesit të dialogut Kosovë-Serbi. (Ilir Dugolli)

DIASPORA E NGULITUR. Paraqet ndarjen e një populli nga trugu i tij i parë etnik-geografik dhe vendosjen e tyre në hapësira të tjera, qofshin ato më të afërta ose më të largëta. Shqiptarët në periudha të hershme historike kishin një shtrirje të gjerë gjeografike dhe për një kohë të gjatë jetuan në një truall territorialisht të pakëputur. Rrjedhat e reja historike dhe gjeopolitike, si dhe rrethanat e rënda sociale dhe ekonomike sollën deri te rrudhja e hapësirës së dikurshme etnike-gjeografike të shqiptarëve, e bashkë me këtë edhe të vëllimit demografik në territorin kompakt etnik. Shqiptarët u ngulitën në shumë vende dhe shtete të botës, madje edhe shumë larg atdheut të tyre, përtej deteve dhe oqeanëve. Vlerësohet se afër 1 milion shqiptarë jetojnë në Europën Perëndimore dhe në Amerikë dhe disa milionë të tjerë në Turqi, Greqi, Itali dhe gjetiu. Rrjedhat e emigrimit dhe e ngulitjes, integrimi në shoqëritë ku jetojnë, vështirësitë për kultivimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar, përfshirë edhe rrezikun e vazhdueshëm nga asimilimi, paraqesin vetëm disa segmente në kuadër të kompleksitetit të veçantë të diasporës së ngulitur. (Hazer Dana)

DIBRA Fuat (1895-1946). Oficer karriere, nacionalist, pinjoll i familjes së Iljaz Pashë

Dibrës. Lindi në Dibër të Madhe, por familja e tij u detyrua të shpërngulej në Shqipëri. Pasi mbaroi kursin e oficerëve në Tiranë, shërbeu në Ushtrinë Shqiptare. Gjatë viteve 1942-1943 ishte komandant i garnizonit të Ulqinit, prej nga në korrik të vitit 1943 dezertoi bashkë me ushtarët e tij dhe iu bashkua forcave nacionaliste në Luftën e Reçit, kundër ushtrisë italiane. Pas kapitullimit të Italisë fashiste (shtator 1943), u riaktivizua në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare dhe, në fillim të vitit 1944 u caktua komandant i Regjimentit IV të sektorit “Kosova” me seli në Prishtinë. Njëkohësisht u emërua komandant suprem i mbrojtjes së kufirit të Kosovës Lindore. Regjimenti IV i Prishtinës, nën komandën e tij përballoi me sukses sulmet e njësiteve partizane në kufirin verilindor të Kosovës, derisa i erdhi urdhri nga komanda e përgjithshme në Tiranë për t’u tërhequr. Me 14 nëntor 1944, bashkë me shtabin e regjimentit, u shoqërua nga forcat e Brigadës V të UNÇ të Shqipërisë, të komanduara nga Shefqet Peçi për në Tiranë, ku u arrestua dhe iu dorëzua autoriteteve jugosllave. U dënua me vdekje dhe u ekzekutua në Prizren. (Muhamet Shatri)

DIBRA Iljaz Pashë (Iljaz Qoku) (shek XIX). Figurë e shquar e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në Klobishtë të Dibrës. U bë i njohur me pjesëmarrjen e tij më 1844 në luftën e Gjoricës (Dibër), kundër Hajredin Pashës. Më 1861 udhëhoqi forcat dibrane kundër përpjekjeve malazeze për të shtënë në dorë viset shqiptare të Shkodrës. Dëshmoi vendosmërinë e tij në luftërat për të hedhur poshtë klauzolat e Traktatit të Shën Stefanit dhe vendimet e Kongresit të Berlinit. Ishte një nga nismëtarët e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Më 10 qershor 1878 kryesoi Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes. Në këtë kuvend u zgjodh kryetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Dokumenti i parë që miratuan delegatët e Kuvendit të Prizrenit, i kryesuar nga Iljaz Pasha, ishte protesta kundër Traktatit të Shën Stefanit dhe çdo projekti për copëtimin e trojeve shqiptare nga Kongresi i Berlinit. Kryesoi gjithashtu Kuvendin e Dibrës, më 1 nëntor 1878, dhe ishte një nga 14 anëtarët e delegacionit që do t’i paraqiste sulltanit kërkesën për bashkimin e vilajeteve shqiptare dhe autonominë e Shqipërisë. (Zeqirja Idrizi)

DIBRA Vjollca (1976-). Shkrimtare dhe studiuese e letërsisë. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm. Mbaroi studimet për letërsi shqipe dhe gjuhë angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. U diplomua për letërsi shqipe në vitin 1999. Më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit (2011). Një kohë (1995-1998) punoi si gazetare dhe arsimtare e gjuhës angleze, pastaj edhe zyrtare në disa organizata ndërkombëtare. Në takimet e ndryshme letrare krijimtaria e saj u vlerësua me çmime. Që nga viti 2011 është mësimdhënëse bashkëpunëtoresh në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës dhe të Prizrenit. Botoi përmbledhjet me poezi: “Suvalë e përgjumur” (1995), “Përtej vetes” (2005), romanin “Minotauri” (2000) dhe librat me studime: “Mozaiku i jetës model i artit” (2009) dhe “Heroinat e deheroizuara” (2011). (Agron Gashi)

DIBRANI Shefqet (1960-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Gërdoc të Podujevës. Shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje, të mesmen në Obiliq, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Shkruan poezi dhe kritikë letrare. Viteve të fundit është marrë dhe me analiza politike. Ka bashkëpunuar me një pjesë të madhe të shtypit shqiptar në Kosovë dhe në diasporë. Ka botuar librat: “Larg pikon hëna” (1994), “Pse e urrej Kadarenë dhe poezi të tjera” (1996), “Qershia e pikëlluar” (1997), “Ditar mërgimi” (1998), “Strehët e gjakut” (2000), “Libra dhe mbresa” (2005), “Zhgënjimi ballkanik” 1, 2 (2005,2006), “Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër” (2007), “Letrat e Agimit” (2008), “Virtyte e Visare” (2010), “11 minuta para orës ’00, ose mirazhi i suksesit të LDK-së” (2011), “Roli historik i LDK-së në ndryshimin e koncepteve politike” (2013), “Anatomia e brymës” (2013), “Sfidë për demokracinë” I, II (2014) dhe “Pinjollët e Rrustem Llukës” (2014). Jeton në Zvicër. (Shaip Beqiri)

DIDA Agron (1950-). Inxhinier i elektroteknikës, pedagog, menaxher. Lindi në Suharekë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, ndërsa studimet e inxhinierisë dhe ato të magjistraturës në Universitetin e Zagrebit. Nga viti 1975 punoi si inxhinier në Televizionin e Prishtinës dhe njëkohësisht u angazhua



AGRON DIDA

si asistent e pastaj si ligjërues në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi deri në vitin 2007. Ka udhëhequr me sukses një numër projektsh inxhinierike për ndër-marrjet: “Trepça”, Termocentralin “Kosova B”, “Elektro-Kosova”, “Metaliku” dhe “Elektromotori” i Gjakovës etj. Ka punuar disa projekte edhe për kompanitë e jashtme. Gjatë viteve ’90 punoi në laboratorin e vet në projektin e elektrokardiografit të kompjuterizuar, të cilin e plasoi në tregun e Kosovës dhe të Maqedonisë. Pas luftës ishte drejtor i parë i përgjithshëm i Postës dhe i Telekomunikacionit të Kosovës (1999), më pas zëvendësministër i Energjetikës dhe i Minierave (2004-2007), udhëheqës i komitetit drejtues të 5 projekteve “ESTAP-III” për sektorin e energjisë të Kosovës (2008-2011) etj. Është përpilues dhe publikues i sajtit me video të përzgjedhura edukative për arsimimin plotësues fillor (www.zgjoj.com) (2015) dhe bashkautor i dy librave shkollorë në lëmin e teknologjisë. (Nebi Caka).

DIDA Ali (1931-1997). Sociolog, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesme. Kreu studimet për filozofi dhe bëri edhe magistraturën nga sociologjia në Universitetin e Beogradit, ndërsa u doktorua në Universitetin e Zagrebit. Një kohë ishte mësimdhënës, më pas dhe drejtor në Shkollën Normale dhe në Gjymnazin e Prizrenit. Më pas bëri karrierën e profesorit në katedrën filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Është autor i disa librave, kryesisht nga fusha e sociologjisë dhe është autor i tekstit universitar “Fillet e sociologjisë” (1974). Kreu detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë dhe ushtroi funksione politiko-shoqërore, ndër të cilat edhe delegat në Kuvendin Federativ të ish-Jugosllavisë. Ishte drejtor i Entit të Kosovës për Bashkëpunim Shkencor me Botën e Jashtme. Botoi një sërë veprash nga fusha e sociologjisë dhe e filozofisë: “Bazat e shkencës mbi shoqërinë” (1979), “Filozofia empiriste dhe racionaliste e kohës së re” (1982), “Pasqyrë e historisë së filozofisë së kohës së re” (1983), “Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë” (1996) etj. (Shemsi Krasniqi)

DIDA Byrhan (1938-). Farmacist. Lindi në Shkodër, shkollën fillore dhe gjymnazin i kreu në Prishtinë. Fakultetin Farmakologji-Biokimi dhe studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb. Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1977). Në fillim punoi në laboratorin e biokimisë në Prizren, kurse pas specializimit të biokiminë mjekësore, emërohet asistent në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1972). Më vonë shkoi për specializim në Hjuston, SHBA dhe pasi kthehet u zgjodh docent dhe profesor inordinar i kësaj lënde në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më pas merr gradën e profesorit ordinar. Dha një kontribut në hapjen e degës së Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1996) dhe ishte koordinator i kësaj dege deri në pension. Mori pjesë në disa kongrese dhe simpoziume dhe është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore. (Rexhep Hoxha)

DIDA Nadire (1930-). Mësuese veterane. Lindi në Prishtinë, ku kreu edhe shkollën fillore pesëvjeçare. Kreu, gjithashtu, edhe Gjymnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. Në vitin 1947 vijoi kurset pedagogjike në Prizren. Punën arsimore e filloi në moshën 16 vjeçare në Prishtinë, në kurset kundër analfabetizmit. Karrierën e mësuesisë e vazhdoi në Prizren, Suharekë, përkatësisht në Prishtinë, fillimisht në shkollën fillore “Emin Duraku”, pastaj në atë “Aca Maroviq”. Është autore e tekstit ndihmës “Fletore pune për klasën I”. U shqua si mësuese e talentuar dhe entuziaste. U nderua me shumë mirënjohje dhe çmime. (Afërdita Deva-Zuna)

DIDA Sedat (1926-2012). Gazetar. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi angleze i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Pas Luftës Antifashiste punoi mësues dhe inspektor shkollash, pastaj ishte nënkryetar i Rrethit të Suharekës. Më 1948 emërohet drejtor i gazetës “Rilindja” në Prishtinë. Më 1956 u arrestua dhe u dënua me pesë vjet burgim, në të ashtuquajturin proces i Prizrenit. Vuajti në kushte izolimi 27 muaj, i akuzuar si spion i Shqipërisë dhe pjesëtar i një grupi të sajuar armiqësor shqiptar. Pas liritimit nga izolimi, u rikthye në “Rilindje”, ku drejtoi faqet argëtuese, faqet e komunave dhe fejtunistikën. Botoi reportazhe e udhëpërshkrime nga bota. Ishte ndër pionierët e gazetarisë kosovare dhe mësues gazetarie për shumë gjenerata. (Zenun Çelaj)

DIFERENCIMI IDEOPOLIK. Fushatë e pushtetit komunist jugosllav për mënjanimin e kuadrove dhe intelektualëve shqiptarë, të cilët angazhoheshin për të drejtat nacionale, duke i akuzuar për nacionalizëm dhe irredentizëm. Filloi menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Ky proces mori përmasa të gjera sidomos pas demonstratave të vitit 1981. Politika zyrtare i cilësoi armiq dhe kundërrevolucionarë bartësit dhe inspiruesit e demonstratave të vitit 1981. Udhëheqja jugosllave vlerësoi se demonstratat e organizuara nga studentët e Universitetit të Prishtinës, të mbështetura edhe nga profesorët dhe inteligjencia shqiptare, cenonin integritetin territorial dhe sovranitetin e Jugosllavisë. Në këtë frymë u hartua “Platforma politike për aksion e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë”. Diferencimi filloi në strukturat udhëheqëse e partiake të drejtuara kundër udhëheqësve komunistë shqiptarë, për të vazhduar në arsim, shkencë, kulturë, ekonomi, shëndetësi. Universiteti dhe institucionet shkencore, kulturore dhe arsimore u shpallën si “kështjella të nacionalizmit dhe kundërrevolucionit”, ndërsa inteligjencia shqiptare u akuzua si frymëzuese e nacionalizmit dhe irredentizmit. Me anë të diferencimit persona të caktuar merreshin në përgjegjësi për bindjet e tyre politike, largoheshin nga procesi mësimor, shkarkoheshin nga pozitat, u ndërrohej vendi i punës dhe kishte raste kur përfundonin në burg. Në procesin e diferencimit ideopolitik u përfshinë emra të njohur të institucioneve shkencore dhe arsimore, profesorë, gazetarë, shkrimtarë, kuadro të kualifikuar, persona me reputacion publik etj. Diferencimi ishte strategji antishqiptare, që kishte për qëllim të mënjanonte nga jeta publike dhe institucionale sa më shumë intelektualë dhe vendin e tyre ta zinin njerëz luajalë ndaj pushtetit. Qëndresa e inteligjencës shqiptare kundër këtij diferencimi pati ndikim vendimtar në proceset e mëvonshme politike në Kosovë. (Sulltane Ukaj)

DIFTERIA. Sëmundje ngjitëse akute, që shkaktohet nga bacili gram pozitiv *Corynebacterium diphtherie*, që kryesisht lokalizohet në tonsilla. Pas periudhës së inkubacionit prej 1 deri në 7 ditë sëmundja mund të ketë forma të ndryshme klinike. Forma më e rëndë është angina difterie, që karakterizohet me temperaturë dhe formim të pseudomembranave në grykë. Ekzotoksina e shkaktarit të sëmundjes

kalon në gjak dhe paralizon nervat motorike, senzitive, kraniale dhe periferike. Po ashtu mund të prekë edhe muskulin e zemrës, duke shkaktuar dëmtime të rënda. Vdekshmëria nga sëmundja është e lartë. Difteria është sëmundje e gjithëbotshme. Në viset tropikale paraqitet shpesh në formë inaparente, por dominon edhe forma lëkurore e sëmundjes. Para epokës së vaksinimit sëmundja ka qenë problem i lartë shëndetësor. Në Kosovë prej vitit 1946-1980 janë regjistruar 3,574 raste të sëmundjes me 345 raste të vdekjes, kurse prej vitit 1975-1980 në Kosovë janë regjistruar vetëm 12 raste. Prej vitit 1980 deri më sot nuk është regjistruar asnjë rast i sëmundjes. Përfshirja e lartë me vaksinën kundër difterisë, mbi 90%, ka bërë që mos të regjistrohen rastet e difterisë që nga viti 1981 dhe është në rrugë të mirë të eliminohet tërësisht. Difteria është e pranishme në shumë shtete të Europës Lindore, përfshirë edhe Rusinë. (Isme Humolli)

DIKA Agni (1950-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Strugë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu Fakultetin Elektroteknik në Universitetin e Prishtinës (UP) (1972), magjistraturën dhe doktoratën (1989) në fushën e shkencave kompjuterike në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit. Për kërkime shkencore qëndroi në Universitetin “Xhorxh Uashington” në SHBA.



AGNI DIKA

Mori pjesë në themelimin e Universitetit të Tetovës, ku ishte dekan i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe prorektor i Universitetit. Gjithashtu punoi si profesor i Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë që nga themelimi i tij, si dhe profesor i Universitetit të Prizrenit. Është autor i disa teksteve universitare, i disa librave nga fusha e kompjuterikës dhe bashkautor i librit “Fjalori i informatikës”. Me punime shkencore ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare dhe një numër syresh i publikoi në revista të ndryshme shkencore. Është marrë edhe me studimin e strukturës së gjuhës shqipe, përfshirë edhe udhëheqjen e projektit “Konvertimi në të folur i teksteve të shkruara shqipe” (2012-

2014). Është anëtar i disa shoqatave shkencore ndërkombëtare. (Nebi Caka).

DIKA Zamir (1969-). Inxhinier, profesor universiteti. Lindi në Dibër, Maqedoni. Kreu Fakultetin e Makinerisë në Universitetin e Prishtinës (UP), ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ku mbrojti edhe tezën e doktoratës (1997). U zgjodh asistent më 1993 në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP), më pas ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës (1997). Nga viti 2001 punon në Universitetin e Europës Juglindore (UEJL) në Tetovë. Në vitin 2010 dhe 2014 u zgjodh rektor i UEJL-it në Tetovë. Realizoi disa vizita studimore në universitete të ndryshme në SHBA. Është autor dhe bashkautor i një sërë publikimesh shkencore dhe pjesëmarrës i konferencave shkencore. Në periudhën 1998-2006 ishte deputet në Parlamentin e Maqedonisë. (Fehmi Krasniqi)

DIKINSON Xholli (Jolly Dickinson) (1945-). Funkionar i institucioneve të BE-së, profesor universiteti, ekspert në fushën e teorisë kuantitative ekonomike, ish-shef i shtyllës IV të UNMIK-ut, përgjegjës për ekonomi në Kosovë në periudhën 1999-2001. Brenda kësaj kohe ai ndihmoi të krijohej një administratë ndërkombëtare në fushën e ekonomisë dhe të financave, duke vënë bazat e institucioneve të domosdoshme ekonomike të Kosovës në rrugën e pavarësisë, siç ishte themelimi i Bankës Qendrore, vendosjen e euros si valutë, vendosja e sistemi fiskal dhe buxhetor, reformat strukturale etj. Si drejtor në drejtorinë e përgjithshëm për çështje ekonomike e fiskale të Komisionit Europian, ishte njëri nga arkitektët e unionit monetar të BE-së dhe të Traktatit të Mastrihtit. Para angazhimeve në BE ishte profesor i ekonomisë dhe i statistikës në disa universitete të Londrës. (Muhamet Mustafa)

DILI Gani (1951-). Gazetar, poet. Lindi në Prishtinë, ku kreu edhe shkollimin fillor dhe gjimnazin. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Nisi punën si gazetar, e më pas redaktor në gazetën e pionierëve "GEP" dhe vazhdoi si reporter i lirë në revistën "Zëri i rinisë", më vonë edhe ushtrues i detyrës së kryeredaktorit. Nga viti 1986 kalon në revistën "Kosovarja", si

redaktor, pastaj edhe kryeredaktor. Pas luftës së vitit 1999 e udhëhoqi revistën "Kosovarja" në cilësinë e editorit. Qysh në fëmijëri është marrë me shkrime, poezi për fëmijë e pastaj edhe me poezi e tregime për të rritur. Ishte shumë aktiv, duke botuar krijimet e tij në të gjitha revistat e kohës që publikoheshin në Kosovë. Botoi përmbledhjen me poezi "Kujtimet e zgjuara" (1971), "Një kokë, një tokë" (1973), "Ora e xhepit" (1975), librin publicistik "Madhështia dhe tragjikja - shoqërime me prof. Canën". Për punë në gazetari ka marrë çmim dhe mirënjohje. (Artan Krasniqi)

DINIQ (Dinić) Mihajlo (1899-1970). Historian dhe akademik serb. Pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi hulumtimit të historisë mesjetare serbe. U shkollua në vendlindje, në Pozharevc dhe në Beograd, e më pas në Francë, ku studioi historinë dhe gjeografinë. Mbrojti tezën e disertacionit në Vjenë (1930). Hulumtoi sidomos në Arkivin Shtetëror të Raguzës (Dubrovnikut). Nga viti 1934 ishte ligjërues në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Që nga ajo kohë publikoi disa studime në revista shkencore. U shqua sidomos në hulumtimin e historisë mesjetare të Serbisë dhe të Bosnjës, xehetarinë dhe tregtinë mesjetare raguzane në kontekst me Kosovën dhe më gjerë. Është autor i disa veprave, si: "Kuvendi i Bosnjës mesjetare" (1955), "Xehetaria mesjetare në Bosnjën dhe Serbinë mesjetare" (1964) etj. Publikoi disa përmbledhje dokumentesh, si dhe një varg artikujsh shkencorë. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë. Në veprat e tij flitet edhe për historinë e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare. Botoi edhe librin e tregtarit raguzan me origjinë arbërore, Michael de Luchari, në të cilin ndeshën edhe emrat e arbërve në qytet dhe rrethet e Novobërdës. (Ramiz Abdyli)

DINO Nebil (1917-1975). Veteran i arsimit, përkthyes. Lindi në Përmet, ku kreu edhe shkollën fillore. Vijoi mësimet në Shkollën e Mesme Teknike Amerikane në Tiranë, kreu Shkollën Normale të Elbasanit. Fillimisht ishte mësues në Berat, ndërsa më 1941 u emërua kryemësues në shkollën e parë shqipe, pastaj inspektor arsimit në Rahovec, mësimdhënës i historisë në Normalen e Gjakovës, për të vazhduar si mësimdhënës në gjimnazin e Prishtinës, drejtor i Shkollës fillore "Vuk

Karaxhiq” në Prishtinë, mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në gjimnazin e Prizrenit, mësimdhënës në kurset pedagogjike në Prizren, Pejë dhe Prishtinë. N. Dino ishte gjithashtu edhe lektor-gazetar në gazetën “Rilindja”, redaktor emisionesh për fëmijë në Radio-Prishtinë, bashkëpunëtor i disa revistave shqipe në Prishtinë. Përktheu disa vepra në gjuhën shqipe (“Princi i lumtur” e Oskar Ualdit, “Betoveni e Revolucioni francez” e Fan Nolit etj.). (Sabit Jaha)

DINOSHA Ferhat (1954-). Politikan, diplomat. Lindi në Dinoshë të Tuzit, në Mal të Zi. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tuz, ndërsa Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës. Deri në vitin



FERHAT DINOSHA

1986 punoi si gazetar, fillimisht në “Rilindje” të Prishtinës, e pastaj në Radion e Malit të Zi, në redaksinë në gjuhën shqipe. Më vonë punoi si përkthyes në organizatat shoqërore-politike të Kosovës, por pas zhvillimeve politike në fillim të viteve '90 u kthye në vendlindje, ku i bashkohet partisë shqiptare, Lidhjes Demokratike në Mal të Zi (LD në MZ). Në vitin 1993 ishte njëri ndër themeluesit e partisë tjetër shqiptare, Unionit Demokratik të Shqiptarëve (UDSH), kryetar i së cilës ishte deri në vitin 2012. Nga viti 1996, në disa mandate, u zgjodh deputet në Parlamentin e Malit të Zi. Në vitin 1998 u bë ministër për të Drejtat e Pakicave Nacionale. Në vitin 2012 u emërua ambasador i Malit të Zi në Republikën e Shqipërisë. Shkruan poezi dhe publicistikë. (Ali Cenaj)

DIKLEA. Qytet ilir dhe krahinë historike në territorin e sotëm të Malit të Zi. Fisi ilir i diokleatëve e mori emrin sipas qendrës së tij, Dioklea. Gërmadhat e qytetit gjenden në vendin ku bashkohen lumenjtë Zeta e Moraça, afër Podgoricës. Sipas disa autorëve të lashtë, aty lindi perandori romak Diokleciani (284-305). Qyteti u rrënuar në fillim të shek. VII nga pushtuesit sllavë. Në shek. IX Dioklea ringjalli traditën e vet dhe u bë qendër e krahinës së gjerë përreth liqenit të Shkodrës. Dioklea mesjetare në veri kufizohej me Travuninë nga Rizoni deri në burimet e lumit Piva; në verilindje me Rashën, në lindje dhe jug

me Bizantin nga burimet e Limit, përmes Bjeshkëve të Nemuna deri në grykëderdhjen e Bunës. Me vendosjen e rregullimit shtetëror, kjo krahinë u quajt Dioklea, ndërsa popullata e shtresuar romane, arbërore dhe sllave u quajt diokleatë. Ky emërtim mbeti në përdorim deri në fund të shek. X, ndërsa nga shek. XI gjithnjë e më shumë zëvendësohet me emrin Zetë. Shteti i Dioklesë nën udhëheqjen e princit Vojisllav, më 1042 u pavarësua nga Bizanti. I biri i Vojisllavit, Mihali, më 1077 u shpall mbret, duke kërkuar ndihmë dhe mbrojtje nga papa i Romës. Shteti u shtri për disa kohë në Tivar, Shkodër, Ulqin, Shas e Drishtë. Në kuadër të tij hynë edhe pjesë të Rashës, Bosnjës dhe rrethet e Raguzës (Dubrovnikut). Me kërkesë të mbretit Bodin, Klementi III themeloi Mitropolinë Diokle-Tivar me seli në Tivar (1089). Nga mesi i shek. XII, kur Dioklea tashmë e kishte zëvendësuar emrin në Zeta, hyri përsëri nën sundimin bizantin, ndërsa tokat e saj u përfshinë në temën e Dalmacisë. (Qerim Dalipi)

DIPLOMACIA DARDANE. Përfshin kontaktet dhe aleancat e dardanëve pas krijimit të shtetit në shek. IV p.e.r. Zhvillimet politike në Dardanië paromake ishin të llojllojshme dhe kjo ishte njëra ndër arsyet pse autorët antikë i panë si popull i veçantë. Shteti i tyre shtrihej në Kosovën e sotme, Maqedoninë Veriperëndimore dhe Serbinë Jugore, përfshirë dhe Nishin, dhe kishte në fqinjësi popuj dhe fise të ndryshme. Kur cenohej interesi, lidhte aleanca të ndryshme me Maqedoninë, shtetin ilir, Republikën Romake, Lidhjen e Etolëve, Lidhjen e Akejëve, sovranin ilir, Aeropin etj. Si forca më e rëndësishme e Europës Juglindore nga shek. III p.e.r. e deri te pushtimet romake të shek. I, zhvilloi politikë të jashtme, luajti rol në rrjedhat e botës antike dhe ishte një ndër shkaktarët e rënies së Maqedonisë.

Në krye të politikës së jashtme ishte mbreti dhe ai përcaktonte delegacionet që e përfaqësonin. Diplomacia u zhvillua në bazë të interesave të Dardanisë dhe veçohet me kundërvënien të politikës pushtuese të Maqedonisë dhe pushtimeve romake. Kështu, iu ofrua strehim trashëgimtarit të fronit të Peonisë, Aristonit, të cilin e tradhtoi mbreti i Maqedonisë, Lizimahu, kur nuk e kurorëzoi për mbret (284 p.e.r.), por iu ofrua ndihma ushtarake mbretit tjetër të Maqedonisë, Ptoleme Keraunit, kundër

invazionit kelt (279 p.e.r.). Diplomacia dardane mbajti relacione miqësore sidomos me medët e peonët, por edhe duke u marrë territore peonëve, kur u shua shteti i tyre. I lejuan autariatët (fqinj veriperëndimor) ta kalonin Dardanië gjatë rënies së bretkosave e minjve dhe lidhën aleancë me Lidhjen e Etolëve dhe Lidhjen e Akejve (221-179). Më 216 p.e.r. e detyruan Filipin t'i ndalte luftimet me romakët, ndërsa më 209 p.e.r. bënë aleancë me Aeropin, sovran ilir, e pushtuan Orestidën dhe morën 20,000 robër. Në vitin 200 p.e.r. delegacioni në krye me Baton, djalin e mbretit Longar, bëri aleancë me romakët. Te konsulli Galba u gjetën me delegacionin e shtetit ilir dhe atë ataman dhe u bënë pjesë e koalicionit antimaqedon dhe pjesëmarrës të Luftës II Romake-Maqedone. Atë vit u dërgua delegacioni në Senatin romak, ku u akuzua Perseu për planet e Maqedonisë për shfarosjen e dardanëve. Atje i përkrahu delegacioni i Thesalisë dhe Senati akuzoi Perseun dhe verifikoi se në Dardani bëhej luftë. Kur Dardania ishte e zënë me pastrimin etnik të planifikuar nga Maqedonia (176 p.e.r.) dhe Perseu luftonte me romakët, mbreti Monun mbajti asnjësi. Diplomacia dardane ishte herë aleate e herë jo e romakëve, siç bëri kur u dha ndihmë etolëve mercenarë në luftë kundër romakëve, kur mbreti e pranoi delegacionin nga Etolia (168 p.e.r.).

Dardania doli nga koalicioni pas krijimit të Provincës së Maqedonisë (168 p.e.r.), kur romakët nuk ia kthyen territoret jugore dhe iu dha vetëm e drejta për tregti me kripë. Pas shpërputhjes së interesave me romakët, u mbështetën te maqedonët dhe iu ofrua strehim Androniksit, kur u ngrit kundër dominimit romak. Dardanët u bashkuan me ilirët e tjerë, por dominoi aleanca me medët, me të cilët bënë aksione kundër provincës romake të Maqedonisë dhe ndaluan për shumë kohë depërtimin e legjioneve romake në veri, në drejtim të Danubit. U rezistuan pushtimeve romake deri në mesin e shek. I, por edhe më pas. (Edi Shukriu)

DISKRIMINIMI NË ARSIM. Privimi i një individi, komuniteti shoqëror etj. nga e drejta dhe mundësitë për t'u arsimuar për shkak të përkatësisë kombëtare, racore, fetare, sociale etj. Diskriminimi në arsim në Kosovë u realizua sidomos pas suprimimit të autonomisë së Kosovës (1989) dhe vendosjen e institucioneve

nën administrimin serb (1990). Nxënësit shqiptarë të shkollave të mesme dhe studentët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës u përjashtuan me dhunë nga objektet e ligjshme, u ndërpre financimi etj., ndërkohë arsimit në gjuhën serbe në Kosovë vazhdonte në kushte normale, edhe më të favorshme se më parë. Ky diskriminim i nxënësve, studentëve, mësimeve shqiptarë, që përbënin shumicën dërrmuese të shkollave në Kosovë, u zyrtarizua nga Serbia edhe me akte ligjore. Në këto kushte arsimit mesëm dhe studimet në gjuhën shqipe u organizuan në objekte të tjera alternative, në shtëpi-shkolla, në kushte tejet të vështira materiale dhe financiare. Nxënësit, studentët, veprimtarët e arsimit ishin vazhdimisht të përndjekur dhe të keqtrajtuar nga autoritetet policore dhe ushtarake serbe, duke përfshirë këtu edhe helmimet e nxënësve shqiptarë të 7 janarit 1993. Diskriminimi i shqiptarëve në arsim në Kosovë nga autoritetet serbe vazhdoi deri në vitin 1999. (Xhafer Ismajli)

DISPANSERITË. Institucione shëndetësore që merren me mjekimin dhe parandalimin e sëmundjeve më të përhapura jorgjithëse dhe ngjithëse, me masat profilaktike, me edukimin dhe promovimin e shëndetit. Në vitin 1940 në Kosovë kishte 5 ambulanca (dispanseri) për fëmijët shkollorë. Në vitin 1954 në Kosovë kishte 4 dispanseri për gra, 8 dispanseri për fëmijë dhe 6 dispanseri antituberkulare. Në vitin 1963 në Kosovë ky numër u rrit në 39 dispanseri dhe këshillimore, si dhe 16 dispanseri antituberkulare. Kosova në vitin 1969/70 numëronte 75 dispanseri, prej tyre 11 dispanseri antituberkulare, 8 ndihmëse, 13 për gra, 2 për sëmundjet e lëkurës dhe ato venerike, 17 për fëmijë, 8 dispanseri shkollore, 16 dispanseri dhe 8 stacione shëndetësore të mjekësisë së punës. Në vitet 1990/91 në Kosovë funksiononin 22 shtëpi të shëndetit dhe secila kishte dispanseritë parashkollore dhe shkollore, dispanseritë për gra dhe shtatzëna, për të moshuar, për sëmundje venerike dhe ato antituberkulare, ndërsa në kudër të organizatave punuese funksiononin dispanseritë e mjekësisë së punës. Në vitin 1990 shëndetësia e Kosovës vendoset nën masa të dhunshme nga qeveria serbe dhe sistemi shëndetësor rrënohet. Pas vitit 2000 fillon zbatimi i formës së re të organizimit, duke u zbatuar parimet e mjekësisë familjare

dhe dispensaritë pushojnë së funksionuari. (Drita Salihu-Zajmi)

DISHA Mentor (1934-2017). Farmakolog, profesor universiteti. Lindi në Dibër, shkollën fillore dhe progjimnazin i kreu në Dibër, kurse gjimnazin e plotë në Tetovë. Diplomoi në Fakultetin Farmaceutik në Zagreb më 1963. Më 1970 ishte kryeshef i laboratorit biokimik i Qendrës Diagnostike në Prishtinë. Specializoi biokiminë mjekësore në Lubjanë dhe më 1975 u zgjodh shefi i laboratorit të radiokimisë në njësinë e mjekësisë nukleare të Qendrës Diagnostike në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin Farmaceutik dhe më 1978 zgjidhet ligjërues i lëndës farmakologji me toksikologji në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1985 mbron temën e doktoratës dhe në vitet vijuese merr titujt përkatës universitarë. Është bashkautor i tri teksteve universitare: “Receptura mjekësore” (1985), “Farmakologjia mjekësore” (1988) dhe “Bazat e farmakoterapisë” (2000). Mori pjesë në shumë simpoziume dhe kongrese dhe botoi një sërë punimesh profesionale-shkencore. Ka merita të veçanta për hapjen e degës së farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Ismajl Dreshaj)

DISHA Osman (1949-). Gazetar i sportit. Lindi në Dibër. Nisi të merret me gazetari që në moshë të re në Televizionin e Prishtinës. Gjatë karrierës së tij në këtë shtëpi televizive komentoj shumë ngjarje sportive nga atletika, futbollin, patinazhin artistik etj. Pas viti 1991, bashkë me familjen emigroi në Oslo të Norvegjisë, ku po ashtu për një kohë u mor me radiogazetari. Njëkohësisht bashkëpunoi me Radiotelevizionin Shqiptar dhe me Radiotelevizionin e Kosovës. Botoi gjithashtu shumë shkrime dhe intervista në gazetën “Kosova sport” gjatë periudhës 2001-2005. (Xhavit Kajtazi)

DITA E MËSUESIT. Festë e mësimdhënësve dhe e nxënësve shqiptarë në Kosovë, në Shqipëri dhe në treva të tjera shqiptare, e cila rikujtohet çdo vit më 7 mars, ditën kur u hap shkolla e parë kombëtare shqipe në Korçë (1887). Filloi të festohet qysh në vitin 1960. Inaugurimi i kësaj feste u bë me qëllim të afirmimit të traditave të mira të shkollës kombëtare shqipe dhe të vlerësimit të punës mësimore, edukative dhe shoqërore të punonjësve dhe veprimtarëve

të tjerë të arsimit. Çdo vit, me rastin e Ditës së Mësuesit, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës ndan mirënjohje të ndryshme për mësimdhënës dhe veprimtarë të dalluar të arsimit. Në respekt të kësaj feste organizohen edhe aktivitete të ndryshme artistike, shkencore etj. (Halim Hyseni)

DITA E SHËNGJERGJIT. Festë popullore me karakter pagan, që shënon fillimin e vitit dhe përcillet me rituale magjike-apatropeike. Festohet më 5 dhe 6 maj në shtëpi, tëbana të bjeshkëve dhe në disa vende tradicionale. Shëngjergji veçmas adhurohet nga fëmijët, të cilët në degë të ndonjë peme bëjnë kolovajza dhe luhaten, duke kënduar këngë rasti. Në ditën e Shëngjergjit, për herë të parë qepen rroba të reja, sidomos për fëmijë ose, në mungesë të tyre, vishen rroba më të mira. Në të kaluarën, më 6 maj, njerëzit zgjoheshin herët në mëngjes, pa lindur dielli dhe ndiznin zjarre në oborre. Ata i stërpiknin me ujë të katër skajet e shtëpisë dhe i zbukuronin dyert dhe dritaret e shtëpive dhe të dyqaneve me lule e gjethe. Këto veprime lidhen me kultin e zjarrit, gërshetuar me kultin e ujit dhe të natyrës. Në shumë vise të Kosovës, më 6 maj, prindërit i zgjonin fëmijët duke i prekur me fletë të njoma të arrave. Nënati i lajnë fëmijët me ujin me fletë arrash dhe lëvozhga vezësh të ngjyrosura, që i ruajnë nga festa e Pashkëve. Larja e fëmijëve besohet se siguron shëndet të gjatë për tërë vitin dhe i bën faqet e tyre të njoma, të kuqe e të bardha. Në vreshta mbledhin fole thneglash, të cilat i vendosnin në magje të bukës, për t’u shtuar begatia gjatë vitit. Në ditën e Shëngjergjit blegtorët dhe barinjët ngjiten tëbanave në bjeshkë. Në këtë ditë blegtorët lidhnin kontrata me barinj të rinj, i ndajnë qengjat nga delet, i thernin qengjat për kurban dhe përgatisin bulmetin. Po ashtu bagëtisë i qesin kripë, i stërpikin me ujë dhe mbi ta hedhin gjethe dhe barishte. Edhe sot Shëngjergji festohet në shumë vise të Kosovës, por disa rituale që lidhen me këtë ditë tashmë janë rralluar. (Shpresa Siqeca)

DIVANI I BOSHNJAKUT (Vehbija e Boshnjakut). Vepra “Vehbije” (në shqip “dhoratë”, “dhunti”) është vepra e vetme e Tahir Efendi Boshnjakut nga Gjakova, e shkruar shqip me alfabet arab në vitin 1835 dhe e botuar në Stamboll. Kjo vepër u shkrua në vargje dhe në prozë, në pajtim me traditën e letërsisë



DIVANI I BOSHNJAKUT

persiane, me qëllim që t'u vijë në ndihmë hoxhallarëve me rastin e predikimeve të tyre. Vepra ka tematikë fetare dhe trajton kryesisht zbrazëtinë e jetës, flet për xhenetin, xhehenemin, për detyrat e njeriut, për detyrat e burrit ndaj familjes, për dijen dhe vlerën e saj etj. Përveç 16 vargjeve të invokimit, përmban 304 vargje si dhe 12 të tjera, të cilat autori i quajti *Bajramije*, e që kanë të bëjnë me Festën e Bajramit. “Vehbije” konsiderohet vepra më e studiuar shqipe me këtë shkrim. Transliterimin dhe transkriptimin për herë të parë e bëri Ismail Haxhi Tahir Gjakova më 1907 dhe e botoi në Sofje. Transkriptimin e “Vehbijes” e ka bërë dhe Idriz Ajeti në studimin e tij monografik për të. Vehbijen e kanë trajtuar në punimet e tyre edhe G. Elezoviq, H. Kaleshi e I. Memishi. (Jahja Hundozi)

DIVANI Jonuz (1906-1985). Veprimtar i arsimit. Lindi në Tivar të Vjetër, ku bëri edhe shkollimin fillor. Normalen e filloi në Danillovgrad dhe e përfundoi në Dubrovnik. Ishte mësues në disa vende të Bosnjës, pastaj në Tivar të Vjetër dhe në disa fshatra përreth. Më 1947 emërohet mësues, më vonë drejtor i shkollës tetëvjeçare shqipe “Bedri Elezaga” në Katërkollë të Anës së Malit, rrethina e Ulqinit. Nën drejtimin e tij shumëvjeçar kjo shkollë shënoi rezultate të shkëlqyera në mësim dhe në aktivitete të lira jashtëmësimore. U bë shkolla më e përmendur eksperimentale në Mal të Zi. Krahas punës mësimore, ai u mor edhe me aktivitete të tjera kulturore dhe arsimore. Themeloi shoqërinë kulturore-artistike dhe universitetin popullor në Katërkollë, udhëhoqi shumë kurse nate kundër analfabetizmit, kurse shëndetësore për femra etj. Për punën dhe rezultatet e arritura J. Divani mori mirënjohje

dhe dekorata dhe u quajt “Makarenko i Anës së Malit.” (Ali Llunji)

DIVIZIONI “IBRI” I LËVIZJES NACIONAL DEMOKRATIKE SHQIPTARE. Formacion ushtarak, i cili u vendos të formohet në Kongresin e Pestë të LNDSH-së në Blinajë (ish-Lipovicë) të Lipjanit në vitin 1946, si pjesë e Ushtrisë për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës. Përgjegjës për formimin e këtij formacioni u caktua Ahmet Selaci. Iniciativën e përkrahën unanimisht të gjithë luftëtarët e Shalës së Bajgorës, të Vushtrrisë, të Llapit, të Drenicës dhe të Pazarit të Ri. Kështu, më 11 gusht 1946, në Kuvendin e Mrizishtës (vend midis fshatrave Kovaçicë e Vesekofc në Shalë të Bajgorës) me miratimin e Komitetit Qendror të LNDSH-së në Shkup, për komandant dhe zëvendëskomandant të Divizionit u zgjodhën Ahmet Selaci dhe Isuf Boletini. Gjithashtu u caktuan edhe eprorët ushtarakë dhe struktura organizative e grupeve dhe batalioneve përkatëse. Komandant i grupit I u zgjodh Faik Boletini, zëvendës dhe adjutant Bislim Bajgora; i grupit II: Osman Bunjaku, zëvendës dhe adjutant Hashim Basholli; i grupit III Ukshin Kovaçica, zëvendës dhe adjutant Smajl Svarqa; i grupit IV Zuhdi Halit Tashevc, zëvendës dhe adjutant Musli Dumoshi; i grupit V Hilmi Zariqi, zëvendës Jetullah Rezalla. Gjithashtu u caktuan edhe komandantët e batalioneve. Me këtë riorganizim ushtarak udhëheqja e Shtabit të Zonës së Dytë Operative synonte ta vazhdojë luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë, në kohën kur disa formacione të Zonës së Parë dhe të trevave të tjera shqiptare tashmë ishin larguar nga Kosova dhe kishin emigruar në Greqi. (Muhamet Shatri).

DIVIZIONI 52 I KOSOVËS DHE I METOHISË. Njësit ushtarak i Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) dhe i aradheve partizane të Kosovës. Në shtator të vitit 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ-së dhe i aradheve partizane të Kosovës u vu nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së të Serbisë. Forcat nacionaliste dhe antikomuniste shqiptare kundërshtuan dhe zhvilluan luftime të përgjakshme kundër depërtimit të njësiteve partizane serbe në Kosovë, gjatë muajve qershor-nëntor 1944, pas vendosjes së administrimit ushtarak më 8 shkurt 1945. Më 14 shkurt vendoset që nga brigadat 1 dhe 4 të Kosovës dhe Metohisë,

brigadat malazeze, brigadat 3 e 5 të Kosovës, Divizioni 50 dhe 26 serb, me rreth 7,000 ushtarë, të formohet Divizioni 52 me shtabin e tij, nën komandën e plotë të administratës ushtarake, në krye me gjeneralin Peter Brajeviq. Divizioni 52 mori gjitha kompetencat e Shtabit Operativ të Kosovës. Në kuadër të këtij divizioni vepronin repartet e artilerisë, të kalorësisë, ndërlihdjes, xhenios dhe të transportit, të cilat mbështetën njësitë ushtarake në operacionet ndëshkimore kundër qëndresës së forcave nacionaliste shqiptare në Kosovë (Drenicë, Mitrovicë, Ferizaj, Kaçanik, Anamoravë-Gjilan, Prizren, Gjakovë etj.). Këtij divizioni iu bashkuan edhe shumë njësitë tjera të ushtrisë serbe e malazeze, të OZN-ës etj., duke ushtruar terror mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare. Divizioni i 52-të u angazhua në mobilizimin e shqiptarëve në njësite partizane dhe dërgimin e tyre jashtë Kosovës, në frontet e luftës në Srem, Bosnjë, Tivar-Mal të Zi, Kroaci e deri në Slloveni. Të mobilizuarit u vunë në vijat e para të luftës, një numër syresh u vranë pas shpine, duke u akuzuar si bashkëpunëtorë të fashizmit. Në qershor të vitit 1945 bëhet transformimi i Shtabit Operativ të Kosovës dhe Divizioni i 52-të hyri në kuadër të Armatës së 5-të të Jugosllavisë, duke pushuar së vepruari si njësitë vete. (Adem Murati).

DIVIZIONI MALOR 21 SS "SKENDERBEG".

U formua nga gjermanët në pranverë të vitit 1944 dhe emri i tij ishte: 21. Waffen-Gebirgs Division der SS Skanderbeg /Albanische Nr. 1/. Komandantit i Divizionit "Skënderbeg" u caktua koloneli Shmith Huber. Formimi i këtij divizioni u përkrah nga një pjesë e shqiptarëve, ngase konsiderohej mbrojtje kundër ripushtimit serb të Kosovës dhe të viseve shqiptare. Për formimin e këtij formacioni ushtarak pati kundërshti edhe nga ana gjermane, ngase mund të shtonte pakënaqësinë e serbëve nazistë. Sipas marrëveshjes, ky njësit duhej të operonte vetëm në Kosovë, Sanxhak dhe në trevat e tjera shqiptare. Me gjithë angazhimin e komandave të Korparmatës XXI, Armatës II të Blinduar dhe Lidhjes së Dytë të Prizrenit, radhët e këtij formacioni nuk u plotësuan asnjëherë, as me rekrutë dhe as me kuadër komandues. Deri më 25 shtator 1944 u rekrutuan 11.398 vetë, ndër të cilët ishin të aftë 9,275, kurse në ushtri hynë 6,491 veta. Sabotimet dhe dezertimet morën përmasa të tilla, sa që gjermanët u detyruan

të ndërmerrnin masa të rrepta si varje, vrasje dhe internime. Për këto arsye, me urdhrin e Komandës Gjermane të 24 tetorit 1944, divizioni u riorganizua në Grup Luftarak të 21-të, që në pikëpamje taktike e operative ishte nën komandën e Korparmatës XXI Gjermane. Ky grup mori pjesë në luftimet përgjatë vijës mbrojtëse të Gruparmatës "E", që po tërhiqej nga Kosova, ndërsa pushoi së ekzistuari në fund të nëntorit të vitit 1944. (Izber Hoti)

DJATHI DARDAN (Caseus Dardanicus).

Djathë i njohur në botën antike. Për herë të parë përmendet në veprën "Përshkrimi i gjithë botës dhe i popujve" (Expositio totius mundi et gentium) të autorit të panjohur sirian nga Aleksandria e Egjiptit (350). Në të përshkruhet eksportimi i djathit dardan në vendet e Lindjes përmes Maqedonisë. Sot njihet si djathi i Sharrit. (Arianit Buçinca)

DJATHI I SHARRIT. Produkt i ngurtë ose gjysmë i ngurtë i qumështit, që përftohet me mpiksjen dhe ndarjen e materies së ngurtë të qumështit nga hira. Është djathë i fortë,



i përgatitur në malet e Sharrit të Kosovës. Përgatitet nga qumështi i deles dhe i lopës. Procesi i prodhimit gjatë viteve është zhvilluar nga mënyra tradicionale në atë moderne. Djathi i Sharrit më herët është prodhuar vetëm nga qumështi i deleve. Bima kryesore që ndikon në aromën dhe shijen e djathit të Sharrit është kopra (*Anethum graveolens* L.), e cila gjendet në lartësi mbidetare mbi 1,100 m. Më vonë banorët e rajonit të Sharrit filluan ta prodhonin djathin edhe me qumështin e lopës. Ata filluan ta mbledhin bimën e koprës për përdorimin e saj si materie përbërëse të jashtme gjatë procesit prodhues, me qëllim të

ruajtjes së vetive origjinale të djathit. Djathi i Sharrit ndryshon, pasi rajoni natyror është i pasur me bimë unike dhe barna aromatike, të cilat mundësojnë formimin e qumështit me shije më të pasur. Djathi është më i përdorshëm në formën e tij të fortë. Ekziston gjithashtu forma e butë e tij. Njëra ose forma tjetër e djathit përgatitet në mënyrë tradicionale me dorë në kolibet e barinjve. Më vonë kompanitë kanë zhvilluar linja industriale për prodhimin e këtij djathi. (Xhevat Domi)

DJEGIA BAKTERIALE E PEMËVE FRU-TORE. Është sëmundje shumë e rrezikshme karantine në Kosovë, e përhapur në pemëtoret me dardhë, mollë, ftua dhe mushmollë. Sëmundjen e shkakton bakteri *Erwinia amylovora*. Shenjat e sëmundjes shfaqen në lule, në gjethë, në fruta, në degëza dhe në trung. Lulet e pemëve të infektuara marrin pamje të lagur, me ngjyrë të mbyllur. Përmes luleve bakteri depërton në gjethë dhe në degëza. Gjethet e infektuara përdridhen, vyshken dhe mbesin të varura në degëza. Lestarët kanë lëvore të zbutur, me ngjyrë të mbyllur, me pamje si të zier, më vonë këto forcohen, vyshken dhe thahen. Përmes degëzave frutdhënëse bakteri depërton në degë të trasha, në të cilat shfaqen njolla të mëdha kanceroze, që zgjerohen dhe përfshijnë trungun në formë nazore, ndërkaq pjesët bimore mbi njolla thahen. Gjatë motit me lagështi në to shfaqen pikëza të eksudatit me ngjyrë të bardhë në të verdhë, që rrjedh dhe përhapet edhe në pjesët e tjera bimore. Nga bakteri infektohen frutat drejtpërdrejt ose depërtimi bëhet përmes bishtit. Frutat e porsaformuar duken si të ziera, me ngjyrë të mbyllur, më vonë rrudhen, forcohen, thahen dhe mbesin të varur në degëza. Përhapja e bakterit nga bimët e infektuara në bimë të shëndosha bëhet me anë të bletëve dhe insekteve të tjerë në fazën e lulëzimit të pemëve. Kontrolli i bakteriozës është i vështirë: rekomandohet prerja e lastarëve të infektuar dhe dezinfektimi me preparate në bazë të bakrit. (Latif Susuri)

DOBRAJ Enver (1968-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Carrabreg të Epërm të komunës së Deçanit. Pasi kreu shkollës e mesme në Deçan, u regjistrua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Me daljen publike të UÇK-së u përfshi në radhët e saj. Në prill të

vitit 1998 udhëtoi për në Shqipëri me grupin e parë të luftëtarëve të Carrabregut, për të marrë armatim. Më pas katër muaj luftoi në vijën e parë të frontit në Carrabreg. Më vonë u inkuadrua në radhët e Brigadës 131 "Jusuf Gërvalla", ku kishte pozita komanduese. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara nga 9 deri më 18 janar 1999 në Dashinoc e Ratish të Epërm. Mori pjesë edhe në luftimet e 27 marsit - 2 prillit 1999, të zhvilluara në Lumbardh dhe Pozhar. Në luftimet e zhvilluara në Dushinoc më 4 qershor 1999 mori plagë të rënda dhe më pas, më 7 qershor vdiq në Spitalin Ushtarak në Maznikë. (Manushe Ramosaj)

DOBRECI Simë (1934-). Mjek, dermatovenereolog, profesor universiteti. Lindi në Braticë, komuna e Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Tivar. Ndoqi



SIMË DOBRECI

studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit dhe, pas diplomimit (1963), punoi si mjek në Tivar e Ulqin. Më 1967 kalon në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, specializimin e kreu në Zagreb, ndërsa më 1973, me t'u themeluar Klinika e Dermatologjisë, u zgjodh asistent e më pas pedagog në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Qëndroi për një vit në ngritje të mëtejme profesionale në Klinikën Dermatologjike Universitare të Vankuverit (Kanada, 1974). Një kohë ishte drejtor i Klinikës. U doktorua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1980 dhe më pas u zgjodh docent, profesor inordinar dhe më 1994 profesor ordinar i dermatologjisë. Më 1991, pas vendosjes së masave të dhunshme serbe në institucionet e shëndetësisë në Kosovë, përjashtohet nga puna. Është autor i tekstit universitar "Dermatologjia", kurse për studentët e stomatologjisë botoi tekstin "Sëmundjet e lëkurës" (1989). Ishte kryeredaktor i revistës "Praxis Medica" (1994-2000). Botoi një sërë punimesh shkencore në revista të ndryshme profesionale. Me kumtesa shkencore mori pjesë në disa kongrese botërore të dermatologëve (Berlin, Bari, Athinë). Është bartës i shumë mirënjohjeve për arritje në fushën e mjekësisë. (Isuf Dedushaj)

DOBROSINI. Vendbanim rural kufitar me Kosovën, 15 km në perëndim të Bujanocit.

Shtrihet në shpatet veriore të Karadakut të Preshevës, në lartësi mbidetare 620-650 m. Brenda periudhës 1948-2002 numri i popullsisë është dyfishuar, nga 536 në 1,037 banorë. Konflikti i armatosur në Luginën e Preshevës (2000), pozita kufitare dhe pengesat për lëvizjen e lirë të njerëzve brenda territorit të fshatit nga prania e forcave të shtuara ushtarako-policore, si dhe largësia nga qyteti i Bujanocit në lindje dhe Gjilanit në perëndim, terreni i papërshtatshëm kodrinor-malor etj., janë disa nga faktorët që kanë ndikuar në shpërnguljen e banorëve kryesisht në drejtim të Gjilanit. Kjo dukuri është intensifikuar viteve të fundit dhe rrezikon të marrë përmasa të shpopullimit. Edhe nga ky fshat një numër i konsiderueshëm i popullsisë aktive emigroi në shtetet e Europës Perëndimore, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër. (Arsim Ejupi)

DOBROSHECI. Fshat në Drenicë, rreth 6 km në verilindje të Drenasit. Lartësia mbidetare rreth 600 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe 1,301 ha. Nëpër këtë vendbanim kalon rruga hekurudhore Prishtinë-Pejë, si dhe ajo automobilistike, që e lidh me Drenasin dhe Rrafshin e Kosovës. Si vendbanim Dobrosheci përmendet në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, pastaj në defterin kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566-74 etj. Në vitin 1921 kishte 45 shtëpi me 351 banorë, në vitin 1948 kishte 504 banorë, ndërsa në vitin 2011 kishte 1,457 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë bujqësia (kultivimi i drithërave, bimëve foragjere) dhe blegtoria. Është bashkësi lokale për vendbanimet: Çikatovë e Vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshan. Ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Ramiz Cërvadiku)

DOBROSHI Arta (1981-). Aktore. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet “Ëndrra e një nate vere” (2001), “Pallati i ëndrrave” (2002), “Moulin Rouge” (2003) etj. Më tutje luajti në filmin artistik shqiptar “Syri magjik” (2005) dhe në atë shqiptaro-çek ”Trishtimi i zonjës Shnajder” (2008). Një nga arritjet e saj më të rëndësishme është roli i Lornës në filmin “Heshtja e Lornës” (Belgjikë, 2008), të regjisorëve belgë Jean-Pierre



ARTA DOBROSHI

dhe Luc Dardenne, me të cilin në Festivalin e Filmit në Kanë (Francë) u nominua në kategorinë “Aktorja më e mirë”. Luajti gjithashtu në filmat e metrazhit të shkurtër, si “Baby” (2010), “Late Bloomers” (2011) dhe “Gently, Gently” (2014). Në festivalin e Kanës u rikthye me filmin e gjatë “Tri botët” (2012). Me rolin e saj në këtë film u nominua për çmimet “Frances Cesar” dhe “Meilleur Espoir Feminine”. Më 2012 u nderua me çmimin “Barbara Tipple” si aktorja më e mirë në festivalin WIFT në Los Angeles (SHBA). Më 2013 ishte laureate e çmimit europian për aktorë më të mirë të rinj “Shooting Stars” në Berlinale. Në Kosovë u nderua me çmimin “Unaza e Katit” (2008). (Doruntina Basha)

DOBROSHI Besim (1935-2014). Gazetar i sportit. Lindi në Gjakovë. Mbaroi Shkollën Normale në Gjakovë dhe punoi si mësues në Korishë të Prizrenit, e pastaj si edukator në Shkollën Normale të Prishtinës. Në vitin 1961 filloi punën në gazetën “Rilindja”, si njëri ndër stenografët e parë në Kosovë. Me pas kalon në redaksinë e sportit të gazetës “Rilindja” dhe për vite me radhë ndoqi zhvillimet sportive në Kosovë dhe jashtë saj, duke u bërë njëri nga themeluesit e gazetarisë sportive në Kosovë. Raportoi nga kampionatet botërore dhe europiane, pastaj nga lojërat olimpike, përfshirë edhe ngjarjet më të rëndësishme sportive në ish-Jugosllavi. Ishte edhe kronist i njohur i ngjarjeve të mëdha të futbollit, shkruante për “Trepçën” dhe për “Prishtinën”, për basketboll dhe për boks. Në vitin 2008, si njërit nga themeluesit e gazetarisë sportive në Kosovë, iu dha Çmimi Kombëtar i Karrierës “Anton Mazrreku”. (Moral Pozhegu)

DOBROSHI Sokol (1914-1987). Jurist, leksikolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, gjimnazin e ulët e kreu në Prizren, gjimnazin e lartë në Negotin-Krajina (Serbi), kurse maturën në gjimnazin e Kragujevcit. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit në vitin 1939. Pas diplomimit, një kohë ushtroi praktikën e avokaturës në Gostivar. Gjatë Luftës

së Dytë Botërore, pas kthimit në Kosovë, u përfshi në lëvizjen për çështjen kombëtare dhe u emërua sekretar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Pas Luftës së Dytë Botërore u dënua dhe vuajti 3 vjet burg. Me të dalë nga burgu, punoi avokat, gazetar dhe jurist në Bankën Investive, në Odën Ekonomike të Qarkut dhe në Këshillin Krahinor të Kosovës. Në vitin 1968 u zgjodh mësimdhënës në Fakultetin Juridik-Ekonomik të Prishtinës, ku ligjëroi lëndët e drejta dhe e drejta e punës. Hartoi fjalorin e parë serbokroatisht-shqip (“Fjaluer serbokroatisht-shqip”, 1953) dhe ishte bashkautor në hartimin e fjalorit terminologjik juridik, që u hartua në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Tiranës. (Osman Ismaili)

DOBRUNA Sokol (1940-). Avokat, pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), avokat. Lindi në Gjakovë. Kreu Fakultetin Juridik dhe punoi në institucione të ndryshme të Kosovës. U burgos disa herë, ndërsa më 1991, si njëri nga themeluesit e Frontit të Rezistencës dhe Bashkimit Kombëtar, u dënua me 6 vjet burg, që më pas iu zvogëlua në 4 vjet. Pas daljes publike të UÇK-së, organizoi paprovijën luftarake me bashkëveprimtarët e tjerë në Gjakovë. Ndërkaq, në shtator të vitit 1998 iu bashkëngjiti radhëve të UÇK-së, ku më vonë u emërua ndihmëskomandant për moral i Zonës Operative të Dukagjinit. Më 16 dhjetor 1989 u emërua shef i shërbimit juridik nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe udhëhoqi Gjykatën Ushtarake që nga 16 dhjetori 1998 deri në përfundim të luftës. Ushtrio profesionin e avokatit në Gjakovë. (Ruzhdi Jashari)

DOBRUNA-SALIHU Exhlale (1949-). Arkeologe e periudhës antike. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, ndërsa studimet për arkeologji i kreu në Universitetin



EXHLALE
DOBRUNA-SALIHU

e Zagrebit (1972). Në të njëjtin universitet kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1995). Në periudhën 1973-1977 punoi në Institutin e Historisë dhe pastaj në Institutin Albanologjik, në sektorin e arkeologjisë (1977-2014). Bëri specializime dhe vizita shkencore në disa vende të

Europës. Në vitin 1976 ligjëroi në Universitetin e Prishtinës, ndërsa gjatë viteve 1995-2001 në Universitetin e Tetovës. Së fundi ligjëroi në degën e antropologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1994 bëhet anëtare e Shoqatës së Arkeologëve të Europës. Bashkëpunoi me Universitetin e Zagrebit dhe të Pulës (Kroaci), të Gracit në Austri dhe me Universitetin e Marburgut në Gjermani. Mori pjesë në simpoziume shkencore dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Është autore e monografisë “Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake-Sepulkrale dhe e kultit” 1-2 (2005) dhe e librit “Saxa loquuntur - Gurët flasin” (2016). Botoi dhe një sërë punimesh shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Pleurat Kabashi)

DOBRUSHA. Fshat në jugperëndim të Istogut, 10 km nga qendra komunale, shtrihet ndërmjet Drinit të Bardhë dhe lumit të Istogut, në rrugën magjistrale Pejë-Mitrovicë, në lartësi mbidetare 450 m. Në aspektin e fizionomisë i takon vendbanimeve të tipit të zgjatur. Ka sipërfaqe prej 1,274 ha, shumica ara dhe livadhe. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori ekstensive. Në dokumentet mesjetare, në harta dhe në defterët osmanë është i regjistruar si vendbanim me emrin Dobrusha. Me këtë emër e hasim edhe në defterin kadastral të vitit 1571. Në defterin e sanxhakut të Prizrenit të vitit 1591 ishte i regjistruar si vendbanim me 18 shtëpi. Në vitin 2011 Dobrusha kishte 1,178 banorë, ndaj 396 banorëve në vitin 1921. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Llukaci i Begut, Prekalla, Saradrani dhe Trubuhoci. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare etj. (Bajram Kafexholli)

DOÇI Ilir (1969-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1994). Po në këtë fakultet kreu studimet pasuniversitare dhe në vitin 2006 mbrojti tezën e disertacionit. Në këtë fakultet u zgjodh asistent dhe më pas u avancua në tituj të tjerë universitarë. Përveç në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së, ka mbajtur mësim edhe në njësi tjera akademike. Ka kryer detyra dhe ka ushtruar disa funksione në institucionet e shkollimit të lartë. Është

autor i disa teksteve universitare, ndër të cilat: "Ushtrime nga teoria e elasticitetit" (1999), "Siguria e mjeteve transportuese" (2012), "Komunikacionit ajror" (2016) etj. Me referate shkencore ka marrë pjesë në disa konferenca dhe kongrese ndërkombëtare. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe ka qenë pjesë e disa projekteve ndërkombëtare të arsimit në Kosovë. Për nevojat e ekonomisë ka kryer disa projekte nga fusha e makinerisë. (Fejzullah Krasniqi)

DOÇI Rexhep (1943-). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në Kërrnicë të komunës së Klinës. Shkollimin fillor e kreu në Klinë, Shkollën Normale në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1968). Nga viti 1975 ishte me punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, deri në pensionim. Ndërkohë kreu studimet pasuniversitare dhe në vitin 1989 mbrojti temën e doktoratës për onomastikën e shqiptarëve të Drenicës. Botoi studime onomastike nëpër revista, përmbledhje punimesh në gazeta shqiptare dhe të huaja. Veprat e tij kryesore nga fusha e onomastikës janë: "Antroponimia e Llapushës" (1983), "Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I" (1990), "Iliro-shqiptarët dhe serbët në Kosovë sipas onomastikës" (1994), "Onomastika e Drenicës" (2005), "Çështje onomastike pellazge-ilire-shqiptare" (2009) etj. Ishte anëtar i redaksisë së revistës "Gjurmime albanologjike", seria e shkencave filologjike. (Naim Berisha)

DOÇIQI Sali (1934-2007). Gjuhëtar, gazetar. Lindi në fshatin Rashtishë të komunës së Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në Ulqin, kurse Normalen dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Diplomoi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1968). Ndoqi studimet pasuniversitare në fushë të shkencave të informacionit në Qendrën Referale të Universitetit të Zagrebit, ku magjistroi më 1974. Po aty dhe doktoroi më 1980. Në fillim të karrierës punoi si mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në periudhën 1967-1972 ishte drejtor i shkollës së mesme teknike "Nikolla Tesla" në Obiliq. Më 1974 kaloi në Institutin "Inkos", ku punoi si bashkëpunëtor i lartë shkencor për informatikë. Për disa vite redaktoi revistën e ndërmarrjes "Kosova" të

Obiliqit. Botoi disa punime shkencore nga lëmi i informatikës. Është bashkautor i një teksti shkollor për informatikën. (Nebi Caka).

DODA Bajrush (1936-2011). Rapsod dhe instrumentist popullor. Lindi në Maznik të Deçanit. Që në vitet '60 rreshtohet në brezin e parë të rapsodëve popullorë që e përbënin këngëtarë të shquar të folklorit muzikor burimor, si: Riza Bllaca, Salih e Feriz Krasniqi, Dervish Shaqa, Demush Neziri, Halil Cërvadiku, Tahir Drenica, Qamili i Vogël, Marash Krasniqi, Mon Sokoli etj. Bashkë me Zenun Gashin bashkëpunuan me Qamilin e Vogël për publikimin e disa disqeve të gramafonit. Repertori i këngëve të tij sa vinte e shtohet përmes valëve të Radio Prishtinës, disqeve të gramafonit, audiokasetave ose emisioneve televizive. Do të mbesin të paharruara këngët e interpretuara nga ai, si: "Moj e mira, moj kablushë kuqe", "Ditë e zezë ish kanë e honja", "Kënga e Halit Gashit", "Kënga e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", "Prej një shpati t'i lëshova sytë" etj. Me zërin karakteristik të malësorit të vërtetë, me mjeshtërinë e rapsodit popullor diti ta ruajë e ta kultivojë me besnikëri melosin autokton të Dukagjinit, Malësisë së Gjakovës dhe Rugovës. (Krenar Doli)

DODA Bardhec (1872-1960). Luftëtar i lëvizjes kombëtare për pavarësinë e Shqipërisë dhe për çlirimin e Kosovës. Veprimtar i lëvizjes demokratike. Lindi në fshatin Dobërdol të Klinës. Mbiemrin Doda e mori nga gjyshi i tij, i njohur në popull si Dodë Rraci. Më 1909 iu bashkua luftëtarëve të çetës kryengritëse antiosmane të Patër Engjëll Palajt në Budisalc të Dukagjinit, e që u vendos nën komandën e Isa Boletinit. Në periudhën mes dy luftërave botërore zhvilloi aktivitet të vazhdueshëm kombëtar. Me krijimin e Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar në vitin 1945, B. Doda u emërua përfaqësues për komunën e Kijevës, e cila ishte nën qarkun e Rahovecit. Pas shuarjes së Lëvizjes Nacionaldemokratike për disa vjet jetoi në ilegalitet, duke u fshehur nga organet e ndjekjes. Në vitet '50 u angazhues sidomos në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi dhe në pajtimin e gjaqeve. (Lush Culaj)

DODA Ismajl (1939-). Mbledhës dhe studiues i folklorit. Lindi në Arbnesh të Krajës, në Mal të Zi. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit

të Prishtinës, ku mbrojti edhe temën e magistraturës dhe tezën e disertacionit të doktoratës nga fusha e folklorit. Është mbledhës i folklorit, njëri nga bashkëpunëtorët më të frytshëm të Institutit Albanologjik të Prishtinës që nga viti i rithemelimit të tij më 1968. Mblodhi këngë kreshnike, balada dhe lloje të tjera të poezisë popullore lirike në shumë fshatra të Ulqinit dhe të Tivarit. Materialet e tij janë botuar në shumicën e vëllimeve të Institutit Albanologjik të Prishtinës, ndërsa një pjesë e madhe e tyre ruhet në arkivin shkencor të këtij instituti. Mori pjesë me kumtesa për folklorin shqiptar në Mal të Zi në shumë konferenca dhe tryeza shkencore. (Sadri Fetiu)

DODA Prenk Bibë (1858-1919). Kapedan i Mirditës, udhëheqës i shquar i rezistencës antiosmane. Lindi në Orosh të Mirditës, në familjen e njohur të Gjonmarkajve. Baba i tij, Bibë Pashë Doda, ishte i pari pashë i krishterë, por që e ktheu Mirditën në qendër të lëvizjes kombëtare. Me vdekjen e të atit, Prek Bibën në moshën 10-vjeçare, me pretekstin e mbrojtjes, autoritetet turke e internojnë në Stamboll, ku kaloi fëmijërinë. Në vitin 1876 kthehet në Mirditë, në udhëheqje kuvendëve dhe të kryengritjeve për mbrojtjen e trojeve shqiptare, pas paqes së Shën Stefanit. Në Lidhjen e Prizrenit ishte nga krerët më aktivë të saj dhe njëri nga drejtuesit kryesorë të degës së Lidhjes për Shkodrën. Më 1880, në krye të luftëtarëve mirditorë mori pjesë në mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, ndërsa në vitin 1881 autoritetet turke e internojnë përsëri për 17 vjet në Anadoll. Me kërkesën e vazhdueshme të krerëve të Mirditës dhe me ndërhyrjen e Papës së Romës e të Fuqive të Mëdha, pas revolucionit xhonturk, më 1908 P. B. Doda lirohet dhe kthehet në vendlindje. Në valën e kryengritjeve antiosmane, në prill të vitit 1911, bashkë me arbëreshin Terenc Toçi e patriotët të tjerë ngre flamurin kombëtar në Kuvendin e Fanit dhe shpall qeverinë e përkohshme të Mirditës. Pas shpalljes së Pavarësisë, mbështet Princ Vidin dhe në qeverinë e formuar prej tij, në krye me Turhan Pashë Permetin, emërohet ministër për Punë Botore (mars 1914), ndërsa me ndryshimet në qeveri emërohet ministër i Jashtëm (maj 1914). Në krye të vullnetarëve mirditorë të thirrur prej tij, merr në mbrojtje Durrësin nga kryengritësit e Esad Pashës, në bashkëpunim edhe me forcat e komanduara nga Bajram Curri, Isa Boletini

etj. Në dhjetor të vitit 1918, në qeverinë e Turhan pashë Permetit të krijuar nga Kongresi i Durrësit, P. B. Doda emërohet nënkryetar qeverie. Në vitin 1919 vritet në një pritë në afërsi të Lezhës. (Endrit Musaj)

DODA Xhemil (1915-1976). Shkrimtar, dramaturg. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tiranë, ndërkaq Akademinë Ushtarake në Torino të Italisë. Me shkrime, fillimisht me poezi, u mor që në moshë të re. Më pas shkroi tregime dhe proza të gjata, si dhe disa drama. Drama e tij më e njohur është "Halit Gashi", e cila në konkursin anonim ishte shpërblyer me çmimin e parë dhe e cila në vitin 1954 u botua në revistën letrare "Jeta e re". Tri dramat e tij: "Halit Gashi", "Kryqi i thyem" dhe "Thonjtë e macës" u botuan më 1979 nga "Rilindja" në Prishtinë. Ka shkruar edhe dramën "Malësorët", si dhe tekstet dramatike "Papuça e vjehrrës" dhe "Lamshi mbrapa skenës". Dramat e tij janë të shkruara në dialektin gegë. Është autor i disa poezive, tregimeve dhe i romanit "Jeta e një maturanti", i cili u botua më 1988. Dramat e tij janë vënë në skenë në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë, në Teatrin e Kombësive (Drama Shqipe) në Shkup, në Teatrin e Mitrovicës dhe në teatrot e ndryshme amatore. (Naime Beqiraj)

DODA Xhevdet (1906-1945). Mësues, pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare, Hero i Popullit. Lindi në Prizren. Familja e tij u shpërngul në Shqipëri. Shkollën normale e kreu në Elbasan dhe pastaj punoi si mësues në Tiranë, Krujë, Milot dhe Durrës. Në zgjedhjet bashkiake të vitit 1936, me mbështetjen e grupit komunist të Korçës, u zgjodh këshilltar. Pas pushtimit fashist të Shqipërisë më 1939, vazhdoi me veprimtarinë antifashiste dhe revolucionare, ndërsa më 1941 kthehet në Kosovë, për t'u angazhuar në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më 1943 italianët e arrestojnë dhe e internojnë në kampin e Porto Romanos në Shqipëri. Pas arratisjes nga kampi, u bashkohet sërisht njësiteve partizane të Kosovës dhe caktohet komandant batalioni. Me formimin e Brigadës së Parë Maqedone-Kosovare, emërohet zëvendëskomandant i saj. Si përfaqësues i luftëtarëve të kësaj brigade, u zgjodh delegat në Konferencën e Bujanit. Ishte njëri ndër përpiluesit e Proklamatës dhe të Rezolutës së

Konferencës së Bujanit si dhe anëtar i kryesisë së Konferencës. Në shtator të vitit 1944, ndërsa ishte i sëmurë rëndë, u arrestua në Prizren nga forcat gjermane dhe u dërgua në kampin e përqendrimit në Mathauzen, ku u pushkatua në pranverë të vitit 1945. (Zijadin Gashi)

DODA Xhevdet (1970-). Aktor. Lindi në Prizren. Studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Realizoi role në shfaqjet: “Martesa”, “Maturantët”, “Makiato boys”, “Llamba magjike e Alajdinit”, “Udhëtimi në Unmikistan” në Teatrin “Dodona”; pastaj “Fizikanët” në Teatrin Kombëtar të Kosovës; “Shtëpi kukulle”, “Im atë e donte Adolfin”, “Një letër e humbur”, “Mbledhje në parlament” etj. në Teatrin e Prizrenit; “Pjata e drunjte” në Teatrin e Gjakovës etj. Realizoi role edhe në filmin televiziv “Darka e dreqit” dhe në seriale televizive “Kombinati” dhe “Taksisti”, pastaj në filmat “Kukumi”, “Mësuesi”, “Anathema”, “Oficeri Krom”, “Martesa”, “Histori maje kulmi” dhe në filma të metrazhit të shkurtër si: “Heshtja” (fitues në Festivalin “Dokufest”, 2013), “Kulla e Sahatit” etj. Gjatë viteve 2000-2003 punoi në kuadër të organizatës gjermane “Kinderberg”, ku realizoi shfaqjen për fëmijë “Koha e luleve”, ndërsa në organizatën “Care International” realizoi filmin për të drejtat e fëmijëve “Ti mundesh” (2003-2004). Është aktor rezident në Teatrin e Prizrenit. (Fadil Hysaj)

DODIQ (Dodić) Lazar (1931-2008). Albanolog, profesor dhe publicist. Lindi në Janjevë. Shkollimin e filloi në Shkodër, për ta vazhduar në Janjevë dhe Pazin. Studimet për filologjinë romane dhe sllave i nisi në Zagreb (1953-1955) dhe pastaj i vazhdoi në Romë. U doktorua më 1966 në Institutin për Studime Albanologjike në Romë me tezën “Shqipëria në veprat e Milan Shufflajt” (L’Albania nell’opera di Milan Shufflay). Kreu specializime njëvjeçare në Bryzh të Belgjikës dhe dy semestra në Munihi. Ligjëroi lëndën gjuhë, kulturë dhe histori të gjuhës shqipe në Universitetin e Bohumit (1966-1996). Botoi librin “Gramatikë shqipe me ushtrime” (Albanische Grammatik mit Übungen”, Bochum 1980). (Naile Mala-Imami)

DOGANA. Institucion përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e kufirit për të parandaluar lëvizjen ilegale të mallrave dhe për të mbledhur tatimet në import. Dogana e

Kosovës është pjesë e Ministrisë së Financave. Mandati i këtij institucioni bazohet në dy akte bazë ligjore, në Kodin doganor dhe të akcizave në Kosovë dhe në Udhëzimin administrativ për implementimin e Kodit të doganave dhe të akcizës. Dogana e Kosovës është një nga institucionet më të rëndësishme në Kosovë, pasi në përgjegjësi të saj janë edhe mbledhja e tatimeve të tjera, përveç tarifës doganore, përfshirë edhe tatimin mbi vlerën e shtuar dhe akcizën. Përveç funksionit të saj si mbledhës kryesor i tatimeve për buxhetin e vendit, Dogana e Kosovës në mandatin e saj ka edhe sigurimin e shëndetit publik. Ky institucion është modernizuar në masë të madhe në vitet e fundit, duke avancuar dhe thjeshtëzuar procedurat e zhdoganimit të mallrave, pastaj duke aplikuar sistemin e avancuar të grumbullimit të të dhënave, duke ndër-tuar sistemin e kontrollit të bazuar në profilet e riskut, duke shkëmbyer informata me agjencitë simotra të vendeve të tjera (edhe para arritjes së mallit) dhe duke bashkëpunuar me agjencitë kufitare në Kosovë. (Petrit Gashi)

DOGANAJ. Fshat në komunën e Kaçanikut, 11 km në perëndim nga qyteza, shtrihet në anën e majtë të lumit Lepenc. Është fshat i tipit të dendur: sipërfaqja është 237 ha, 957 banorë (2011), ndaj 333 banorë në vitin 1948, me dendësi prej 402 b/km². Gjetjet e shumta arkeologjike dëshmojnë për lashtësinë e vendbanimit. Me emrin Doganaj për herë të parë është regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Është seli e bashkësisë lokale. Ka shkollën fillore, qendrën e mjekësisë familjare, bibliotekën etj. (Shpend Agaj)

DOGANI Abdylhaqim (1880-1955). Veteran i arsimit, autor tekstesh shkollore. Lindi në Gostivar, ku kreu edhe shkollën fillore turke. Gjithashtu mbaroi gjimnazin në Stamboll, ku u regjistrua për studimin e farmacisë. Pas dy vjetësh studimi, kthehet në vendlindje dhe emërohet mësues në shkollën turke të qytetit. Si mësues shërbeu 42 vjet në Gostivar dhe në Shkup, ku pas revolucionit xhonturk në idadijen e këtij qyteti mbajti mësimin e gjuhës shqipe me alfabet turko-arab. Shkroi 17 tekste shkollore dhe vepra të tjera didaktike e metodike për mësimin e lëndës së fesë islame, të turqishtes, të historisë, të abetares osmanishte dhe turqishte, përfshirë edhe “Abetare shqip me alfabet arab”,

si dhe “Abetare” (1946), e cila është njëra nga abetaret e para shqipe ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte bartës i Urdhrit “Naim Frashëri”, akorduar nga presidenti i Shqipërisë. (Myqereme Rusi)

DOKET DHE ZAKONET. Janë tërësi veprimesh që zbatohen në jetën shoqërore dhe familjare, në marrëdhëniet dokesore-juridike dhe rreth punëve në komunitet. Doket dhe zakonet shoqërore dhe popullore-juridike i karakterizojnë sjelljet e individit në shoqëri. Në të kaluarën jeta familjare dhe shoqërore zhvillohej sipas dokeve e ligjeve të pashkruara, shumica e të cilave gjenden të përfshira në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Nderimi i të parëve të familjes ka qenë i njohur qysh nga ilirët dhe është përcjellë deri më sot, sidomos në festën e shtëpisë e të fisit dhe në kultin e gjarprit. Përshëndetja karakterizon veprime, fjalë e shprehje të mirësjelljes në mes të njerëzve në jetën e përditshme dhe në takime të rastit. Mikpritja është një zakon i lashtë, që ruhet me besnikëri në Kosovë, si dhe në të gjitha trevat e tjera shqiptare. Shprehja “bukë e kripë e zemër” ende është e pranishme ndër kosovarët. Burrëria dhe besa janë institucione pozitive shqiptare dhe tregues të mirëfilltë etnikë. Besa është institucion i lartë moral i shqiptarëve, që është trashëguar nga kohët e hershme. Besa jepej në raste të gjakmarrjes, pajtimit të gjaqeve dhe në raste luftërash. Doket dhe zakonet familjare zbatohen me rastin e lindjes, të martesës dhe të vdekjes dhe gërshetohen me rite, besime e besëtytni të ndryshme. Doket dhe zakonet rreth punëve zbatohen me rastin e fillimit dhe të përfundimit të punëve bujqësore e blegtorale, si dhe me rastin e ndërtimit të shtëpisë së re. Veçohen doket dhe zakonet me rastin e hapjes së themeleve të shtëpisë së re, me rastin e hyrjes në shtëpi të re dhe ndezjes së zjarrit të parë në vatër. Doket dhe zakonet përcillen me besime e besëtytni të ndryshme. Ato janë ruajtur edhe sot e kësaj dite, qoftë në formë arkaike apo të modernizuar. (Shpresa Siqeca)

DOKO-MEKULI Suade (1931-2010). Inxhinieri e arkitekturës, mësimdhënëse universitare. Lindi në Ohër, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ohër, ndërsa studimet për arkitekturë në Universitetin e Shkupit (1958). Ishte e para arkitekte shqiptare në Kosovë. Pas diplomimit u punësua në ndërmarrjen ndërtimore “Ramiz

Sadiku”, ku udhëhoqi sektorin e projektimit. Ishte projektuese përgjegjëse në byronë “Kosmetprojekt” (1962-1967). Në vitin 1968 u zgjodh asistente dhe më pas ligjëruese e lëndës konstruksionet arkitektonike në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Si autore dhe bashkautore hartoi një numër të madh të projekteve të ndërtesave të banimit kolektiv në Prishtinë dhe në qytetet e tjera të Kosovës si dhe një numër objektesh afariste dhe komerciale, siç janë Fabrika e Mobileve në Ferizaj, Posta Qendrore në Prishtinë, Posta në Deçan, Gjykata në Viti etj. Kreu edhe detyra dhe funksione me përgjegjësi në organet drejtuese të Fakultetit Teknik dhe të arsimit të lartë, të shkencës dhe të kulturës. (Dervish Qerreti).

DOKUMENTET DHE DORËSHKRIMET NË GJUHËT ORIENTALE. Në Kosovë ruhen një numër i rëndësishëm i koleksioneve të dokumenteve dhe të dorëshkrimeve në gjuhët orientale (arabisht, osmanisht, persisht) si dhe shqip me alfabet arab. Këta dokumente janë mjaft të vjetër dhe ruhen në biblioteka të institucioneve të ndryshme të Kosovës dhe ndër posedues privatë. Numri më i madh i tyre ruhet në Arkivin e Kosovës, ku ekziston një koleksion me rreth 3,000 dokumente, të gjitha origjinale dhe të hartuara nga administrata dhe zyrat e institucioneve të Kosovës për nevojat e popullsisë vendore. Kronologjia e tyre filloi me vakëfnamenë e Mehmet Pashë Kaçanikut, e legalizuar në vitin 1608, dhe vazhdoi deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Nga këta dokumente më së shumti gjejmë vërtetime me karakter të ndryshëm, kërkesa për leje kurorëzimi, për leje shkuroëzimi, regjistra të ndryshëm financiarë, regjistra të popullsisë së fshatrave të ndryshme, vërtetime të trashëgimisë, vërtetime të ushtarëve shqiptarë të dekoruar në Perandorinë Osmane, autorizime, shkresa, raporte, tapi dhe fermane. Një numër i konsiderueshëm i këtyre dokumenteve vijnë nga bibliotekat private dhe publike. Ka nga ato që janë shkruar e kopjuar në Kosovë, por ka edhe nga anë të ndryshme të botës islame. Dorëshkrimet dhe dokumentet ruhen në Arkivin e Kosovës, në Institutin e Mbrojtjes së Monumenteve në Prizren, në bibliotekën e Gazi Mehmet Pashës në Prizren, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, në bibliotekën e Bashkësisë Islame të Kosovës etj. Dorëshkrime të këtij lloji gjenden edhe nëpër xhami dhe në

biblioteka private, si në bibliotekën e Ahmed Pllanës në Prishtinë, në bibliotekën e Beqir Saharës në Pejë, në bibliotekën e Hamdi Dolit, Haxhi Sheqerit dhe Fahri Iljasit në Gjakovë etj. Dorëshkrime orientale ka edhe në disa teqe, si në Teqenë e Halvetive në Prizren, në Teqenë e Melamive, në Teqenë e sheh Iljazit dhe në Teqenë e Madhe të Halvetive në Rahovec, në Teqenë e sheh Musasë, në Teqenë e sheh Salihit dhe në Teqenë e sheh Eminut në Gjakovë etj. Në mesin e këtyre koleksioneve ruhen dorëshkrime dhe autografe të autorëve shqiptarë. Për nga përmbajtja mbizotërojnë temat juridike, filozofike, fetare, letrare, gjuhësore, të shkencave të natyrës etj. Në shumicën e tyre, pranë tekstit të veprës bazë, në margjina gjenden edhe shënime të ndryshme, të cilat ofrojnë një varg informacionesh me rëndësi për autorin dhe kopjuesin e veprës, për pronarët ose lexuesit e saj. (Sadik Mehmeti)

DOLAKURizah (1949-). Kompozitor, dirigjent. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore. Shkollën e Mesme të Muzikës e nisi në Prizren dhe e kreu në Prishtinë. Filloi me punë si pianist në produksionin muzikor të Radiotelevizionit të Prishtinës. Më pas u regjistrua në Akademinë e Muzikës në Beograd, u kthye sërish në RTP si instrumentist e udhëheqës i orkestrës revyale deri në largimin kolektiv më 1990. Si kompozitor e orkestrues mori pjesë në festivalet “Akordet e Kosovës”, “Poli-fest”, “Shou fest”, “Notafest”, “Kënga magjike”, Festivali i Muzikës i Radiotelevizionit Shqiptar, Festivali i Opatisë etj. Në shumicën e tyre u shpërblye për orkestrime. Njihet ndër orkestruesit më të mirë të muzikës së lehtë dhe të xhazit. Ka krijuar për këngëtarët Q. Dushku, B. Islami, G. Pallaska, M. Mengjiqi etj. Nga viti 2000 nisi punë në Radiotelevizionin e Kosovës si dirigjent i big-bendit. Është autor albumesh muzikore me këngë të vjetra qytetare dhe përpunime të folklorit shqiptar. (Xhevdet Gashi)

DOLI Flamur (1951-). Inxhinier i arkitekturës, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Mitrovicë, kurse studimet e arkitekturës (1974) dhe ato pasuniversitare në Fakultetin e Arkitekturës në Shkup (1984). Disertacionin e mbrojti më 2008 në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP). Pas studimeve u zgjodh asistent në Fakultetin



FLAMUR DOLI

e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së, më pas ligjërues dhe në vitet në vijim mori titujt e tjerë universitarë për lëndët gjeometria deskriptive dhe perspektiva gjeometrike. Ligjeron edhe lëndët banimi tradicional në Kosovë dhe teoria dhe praktika e restaurimit. Është autor i monografive studimore “Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar” (1993), “Të krijuarit dhe arkitektura” (1997), “Arkitektura tradicionale-popullore e Kosovës” (2001) dhe “Arkitektura vernakulare e Kosovës” (2009). Mori pjesë me punime shkencore në konferenca ndërkombëtare në disa vende të botës dhe është autor i ekspozitave shkencore nga arkitektura popullore e Kosovës të mbajtura në Kosovë, Gjermani e Turqi. Hartoi projektet për restaurimin e objekteve të kullave të llojit të Rrafshit të Dukagjinit në Junik, Prekaz (2004), Mitrovicë etj. Është anëtar i asociacioneve vendore dhe ndërkombëtare të arkitektëve. (Vlora Navakazi).

DOLI Krenar (1985-). Etnomuzikolog. Mësimet e para për klarinetë i kreu në Shkollën e Ulët të Muzikës në Gjakovë, më pas i vazhduoi në gjimnazin “Hajdar Dushi”. Më 2003 vijoi studimet në Akademinë e Arteve, dega muzikologji, në Tiranë, ku u diplomua në vitin 2008. Në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe studimit të artit (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtimi etnomuzikologji, kreu studimet pasuniversitare (2014) me temën “Ceremonia e dasmës në qytetin e Gjakovës”, i udhëhequr nga prof. M. Dibra. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore, duke trajtuar çështje të muzikës folklorike, përkatësisht popullore dhe tradicionale shqipe. Ka realizuar ekspedita në terren, me qëllim të vjeljes së lëndës folklorike në treva të ndryshme shqiptare. Është autor i teksteve studimore “Muzika në reflekset e kohës” dhe “Gjakova brenda muzikës”. Punon në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në sektorin e etnomuzikologjisë (Besa Luzha)

DOLI Shkelzen (1971-). Violinist. Lindi në Elbasan. Mësimet e para për violinë i mori në Gjakovë. Disa çmime në konkurset rajonale muzikore bënë që të shquhet talenti



SHKELZEN DOLI

i tij dhe në vitin 1986 u regjistrua në Gjimnazin Muzikor të Novi-Sadit, me pedagogët Imre Jambor e Csaba Szima. Në moshën 17-vjeçare fitoi çmimin e parë në konkursin për muziktarë të rinj në ish-Jugosllavi.

U regjistrua në klasën e Evgenia Tschugaevas në Akademinë Muzikore në Novi-Sad. Më 1992 vazhdoi studimet në Universitetin Muzikor të Vjenës, me pedagogët Dora Schwarzberg, Michael Frischenschlager, Josef Hell. Fillimisht i angazhuar dhe më pas pjesëtar i rregullt i violinave II në kuadër të Orkestrës Filarmonike të Vjenës. Paraqitet si solist dhe në ansamble kamerale, si “Toyota Master Players”, “Virtuozët vjenezë”, “Rene Staars Ensemble Wiener Collage”, “The Philharmonics” etj. në Europë, Amerikën Veriore, Afrikë, Izrael, Japoni etj. Sh. Doli zë një vend të konsiderueshëm në skenën muzikore vjenezë dhe shqiptare. Së fundi ka themeluar Ansambli “Philharmonisches Ensemble Wien”, me të cilin më 1 janar 2015 u prezantua në koncertin e përvitshëm të Vitit të Ri në Vjenë, me vepra të ndryshme dhe shqiptare. (Besa Luzha)

DOMANIKU Besart (1970-). Pingpongist, trajner, gjyqtar ndërkombëtar. Lindi në Prishtinë. E filloi karrierën si pingpongist në moshën 10-vjeçare, si nxënës i shkollës fillore “Emin Duraku” në Prishtinë. Klubi i tij i parë ishte KPP “Telefoniku”, me trajner Bedri Ajetin. Shumë herë u shpall kampion i Kosovës në të gjitha grupmoshat. Ka qenë anëtar standard i përfaqësueses së Kosovës në pingpong. Në vitin 2011 u certifikua si trajner i nivelit të parë i pingpongut nga ITTF-ja, ndërsa gjyqtar ndërkombëtar është bërë në vitin 2012. Në vitin 2012 u emërua përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës në pingpong. (Bekim Aliu)

DOMI Faton (1956-1987) Futbollist. Lindi në Gjakovë. Filloi të merret me futboll që herët dhe në moshën 17-vjeçare kaloi në ekipin e parë të “Vëllaznimit”, ku luajti dy vjet. Në stinorin 1974/1975 shkoi te KF “Sarajeva” dhe më pas te KF “Prishtina”, duke e shoqëruar këtë skuadër nga liga e parë e Kosovës, pastaj në ligën e dytë dhe së fundi në ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Më 1987 u kthye te “Vëllaznimi”

vetëm për disa muaj, duke arritur suksesin më të mirë me këtë skuadër. Vdes në nëntor të atij viti, bashkë me futbollistin Fevzi Rama, në një aksident komunikacioni në Volljakë të Klinës. (Moral Pozhegu)

DOMI Shaban (1912-1987). Aktor. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Ishte njëri ndër pionierët e skenës teatrore dhe ndër themeluesit e teatrit të kukullave dhe fëmijëve në Kosovë. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u angazhua nga viti 1948. Gjatë karrierës së tij prej aktori realizoi një sërë rolesh teatrore, kryesisht në zhanrin e komedisë. Ndër rolet e tij më të suksesshme në TPK janë: Mjeku në “Vjedulla para gjyqit” (1950), Babai në “Martesa” (1950), Jusufi në “Halit Gashi” (1955), Marku në “Koshtana” (1955) etj. (Arian Krasniqi)

DOMI Xhevat (1941-). Veteriner, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Veterinarisë dhe studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Veterinarisë të Universitetit të Zagrebit (1970). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Veterinarisë të Universitetit të Beogradit (1977). Një kohë punoi në Kombinatin bujqësor industrial “Ereniku” në Gjakovë dhe në Institutin për Blegtori dhe Veterinari në Prishtinë. U zgjodh ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës për lëndën mikrobiologji (1976). Po në këtë fakultet gradohet në të gjithë titujt universitarë. Publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale në revista në vend dhe në botën e jashtme. (Ragip Kastrati)

DOMI Yilka (1982 -1999). Poete, dëshmore. Lindi në Gjakovë. Ka qenë poete, valltare dhe aktore. U vra më 7 maj 1999 në betejën e njohur të Çabratit. Trupi i saj u gjet katër vjet më vonë dhe u rivarros më 2003 në Kodrën e Çabratit. Në vitin 2001 u botua libri me poezi “Fluturimi i fundit me dallëndyshet”, i përgatitur nga A. Byci. Me iniciativën e aktivistes gjermane, Ingeborg Johaim, nga “Medica Mondiale” dhe me ndihmën financiare të kësaj shoqate, ky libër është botuar në gjuhën gjermane dhe angleze. Me ndihmesën e gazetarit amerikan, Chris Stephen, më 2002, disa poezi të saj dhe

një shkrim për të janë botuar në gazetën “New York Times”. Në vitin 2000, Klubi letrar “Gjon Nikollë Kazazi” i Gjakovës themeloi çmimin letrar “Yllka Domi” për librin më të mirë debutues të krijueseve të reja. (Adil Olluri)

DOMINIKANËT. Urdhër kishtar katolik, i themeluar nga Shën Dominiku (1170-1221), në Francën Jugore. Urdhri u zyrtarizua nga papa Innocentius III dhe u aprovua nga papa Honorius III (1216). Zyrtarisht u quajt “Urdhri i fretërve predikues” ose dominikanët (“Fretërit e bardhë”). Pas themelimit të urdhrit, dominikanët përveç në Kroaci, Bosnjë e Hungari i ndeshim edhe në trevat arbërore. Nga shek. XIV-XV kuvende të tyre kishte edhe në qytete të Kosovës: Bërvenik, Janjevë, Novobërdë, Prishtinë, Trepçë etj. Vargu i personaliteteve të shquara arbërore të këtij urdhri ishte Dominik Topia (1351-1364), ipeshkëv i Korçullës dhe argjipeshkëv i Zarës; Ndre Durrësaku (1387-1393), argjipeshkëv i Raguzës; pastaj Valeri Novobërdasi, Gjon Vaji i Novobërdës (Johannes Olearius, i cili sipas bullës papnore të 13 marsit 1451, kishte inauguruar kuvende dominikane në Kosovë). Emra të shquar dominikanë arbëror ishin edhe Gjon Durrësaku (1392-1397, profesor në Universitetin e Padovës); Aleks Durrësaku (1393, lektor në Universitetin e Bolonjës); Gjon Mazreku i Durrësit (1393, prior provincial i provincës së Dalmacisë); Shtjefën Zaharia (1393, konventual i Kuvendit të Ulqinit); Gjini Gazulli (c. 1400-1465, profesor në Universitetin e Padovës); fratër Aleks Durrësaku (1477, profesor në Perugja); Gjon Ndre Suma i Shkodrës (1477, profesor në Perugja); Jan Nika (1488, pleban i Novobërdës); motra Domenika nga Tivari (1492-1493); Alberti i Novobërdës (1499-1529, konventual i Kuvendit të Raguzës); Lukë Mazi i Trepçës, i shquar për kujdesin ndaj të krishterëve arbërorë në Kosovë gjatë sundimit turk (1534-36) etj.

Pjesëtarët e urdhrit dominikan me seli në Durrës rreth vitit 1380 themeluan “Studium Generale”, përkatësisht Universitetin e Durrësit, i cili, për shkak të sulmeve osmane ishte detyruar të bartej në Zarë. Për rektor të parë i “Studium Generale” të Zarës qe emëruar Gjon Durrësaku (1396). Me rënien e Kosovës (1455), të Shkodrës (1479), të Durrësit (1501), të Tivarit dhe Ulqinit (1571), urdhrat e mëdha arbërore (dominikanët e benediktinët) pushuan pothuajse tërësisht së vepruari. (Jahja Drançolli)

DONACIONI. Dhuratë që jepet pa obligim kthimi për njerëzit në nevojë. Zakonisht dhurata bëhet nga ana e individëve apo organizatave të ndryshme për organizatat joqeveritare apo fondacione që merren me bamirësi. Dhurata mund të jetë në formë të mjeteve të gatshme financiare apo të mirave të tjera materiale. Edhe pse shpesh konsiderohen të njëjta, donacioni ndryshon nga granti, sepse përfituesit nuk i vendosen kushte dhe kufizime lidhur me mënyrën se si të përdoren mjetet e dhuruara. Në periudhën e pasluftës Kosova ka përfituar shumë nga donacionet e organizatave të ndryshme joqeveritare. Këto donacione shënuan kulmin në periudhën 1999-2001 dhe luajtën një rol të rëndësishëm gjatë procesit të rindërtimit të vendit. Në vitin 1999 rreth 60% e ndihmës së jashtme ishte dhënë si pjesë e programit emergjent humanitar. Përmes këtij programi emergjent u shpërndanë ushqime, barna, strehim i përkohshëm, si dhe pajisje për bujqësi. Ndihmat u shpërndanë kryesisht nga UNHCR-ja dhe u financuan nga donatorë të jashtëm. Komuniteti i donatorëve në Kosovë shpenzoi rreth 320 milionë euro si ndihmë për sektorin e banimit, përmes së cilës u rindërtuan dhe u riparuan gjysma e shtëpive të djegurura dhe të dëmtuara gjatë luftës. Në vitet në vijim, me stabilizimin e gjendjes dhe kthimin e njerëzve nëpër shtëpi, ndihma emergjente humanitare u zvogëluar dhe u rrit rëndësia e ndihmës së jashtme për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, e shpërndarë kryesisht në formë të granteve. (Venera Demukaj)

DORËZANIA. Veprim juridik me të cilin një person (dorëzanësi) detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë. Dorëzania qëndron vetëm për një detyrim efektiv. Ajo mund të jepet si për detyrimin e ardhshëm, ashtu dhe për një detyrim me kusht. Dorëzania u praktikua gjerësisht në marrëdhëniet private, në veprimtarinë administrative e gjyqësore si brenda bajrakut, ashtu edhe jashtë tij. Ajo më parë kërkohet e pastaj pranohej ose refuzohej. Në Kosovë me rastin e lidhjes së kontratave përdorej një dorëzani e veçantë, që quhej “fluturim dorëzani”. Në Dukagjin kësaj i thoshin “me shti qefil për së kundrejt”. Personaliteti i dorëzanësit ushtronte ndikim të madh në mes të palëve. Atij duhej “t'i punonte fjala, kuleta e pushka”. Shpeshherë vendimet e kuvendeve

shoqëroheshin me vënien e dorëzanëve, që do të garantonin zbatimin e tyre. Këta quheshin “dorëzanët e fisit” ose “dorëzanët e usullit”. Në disa raste dorëzania ishte reciproke, të dy palët njëkohësisht vinin dorëzanë, “me u dorëzanua”. Kur shkelej dorëzania merreshin masa zakonore, administrative e shoqërore ndaj atij që i shmangej detyrimit dhe dorëzanësi gëzonte përkrahjen e bajrakut dhe pastaj merreshin masa. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit “Me ba me u pendua dorëzani e me dashtë me dalë dorzanije, kanuja nuk e len, sepse: ‘Dorëzani nuk hin për me mbajtë në mend, por për me la.’” (Bashkim Lajçi)

DOZON Ogyst (August) (1822-1890). Diplomati francez, albanolog dhe ballkanolog. Studioi për letërsi klasike dhe moderne në Paris. Ishte konsull në Ballkan (në Beograd, Mostar, Plovdiv, Janinë, Qipro dhe në Selanik). Interesimet e Dozonit lëvizin në hapësirat etnike shqiptare, sllave, helene dhe rumune, italiane e gjermanike, e deri tek ato indiane e aziatike. Shqipen e kishte mësuar në Janinë. Botoi veprën “Doracak i gjuhës shqipe” (Manuel de la langue Albanaise, Paris 1879), pjesa e parë e së cilës përmban përralla, këngë popullore, proverba dhe tekste të tjera të pabotuara, ndërsa pjesa e dytë ka një gramatikë të shqipes të bazuar në toskërishten, kryesisht në të folmen e Përmetit. Në fund të librit jep një fjalor shqip-frëngjisht, me rreth 4,000 fjalë. Përrallat u botuan vetëm frëngjisht në librin “Përralla shqiptare” (Contes albanais, Paris 1881), pajisur me një hyrje dhe një pjesë të gjerë shkoqitëse. (Mensur Vokri)

DRAGA Ajdin (1870-1914). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në Mojtir të Tutinit, afër Novi Pazarit. U shkollua në Novi Pazar dhe në Mitrovicë. Ishte pjesëmarrës në organizimin Lidhjes së Pejës. Në vitin 1908 u anëtarësua në Klubin e Shkupit në cilësinë e këshilltarit dhe gjithashtu ndihmoi në themelimin e Klubit të Kumanovës. Kontribuoi dhe mori pjesë aktive në kryengritjet kundë osmane të viteve 1908-1910 dhe në atë të përgjithshme të vitit 1912. Ishte pjesëmarrës i Kuvendit të Vlorës në vitin 1912 dhe anëtar i Pleqësisë (senatit), si përfaqësues i Kosovës. Në qershor të vitit 1913 mori pjesë në delegacionin e qeverisë shqiptare që protestoi para Fuqive të Mëdha për çështjen e kufijve të Shqipërisë. Nga Qeveria e Vlorës u

ngarkua me detyrën për t’i ndihmuar krahinat e Shkodrës për shtrirjen e sovranitetit të qeverisë shqiptare. Në qershor të vitit 1914 mori pjesë me grupin e përfaqësuesve të Kosovës në takimin me princ Vidin. Luftoi kundër forcave të Esat pashë Toptanit, nën udhëheqjen e Isa Boletinit dhe Bajram Curri, ku edhe u vra më 14 qershor 1914 në Rashbull, afër Durrësit. (Naim Musliu)

DRAGA Ali Pashë (shek. XIX). Veprimtar i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në Mojtir të Tutinit, në sanxhakun e Pazarit të Ri. I ati i tij, Ali Ferhat bej Draga ishte pronar tokash, derë me ndikim në krahinë. Për vite shërbeu në një xhami në Pazarin e Ri. Edhe të birit i vuri emrin e vet, Ali, dhe ndikoi për shkollimin e tij. U dallua për trimëri dhe si prijës popullor. U shqua në Luftën ruso-turke të vitit 1876-1877, sidomos në Betejën e Plevnës (1887), në të cilën drejtoi luftëtarët shqiptarë të Sanxhakut dhe Mitrovicës. Për aftësitë e treguara mori titullin pashë. Ishte aktivist i dalluar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes. Dha kontribut të veçantë për bashkëjetesën midis shqiptarëve dhe boshnjakëve në rajonin veriperëndimor të vilajetit të Kosovës, si dhe për mbrojtjen e trojeve shqiptare në viset e Shalës së Bajgorës, të Kolashinit dhe të Sanxhakut. (Endrit Musaj)

DRAGA Ferhat (1873-1944). Veprimtar politik i të drejtave kombëtare shqiptare në Kosovë dhe Sanxhak gjatë luftërave ballkanike, Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Lindi në Mitrovicë. Studimet i përfundoi në Stamboll, ndërkaq u angazhua si i ri në veprimtari politike për çështjen kombëtare. Ishte përkrahës i zhvillimit të arsimit dhe të shkollave shqipe dhe të përdorimit të alfabetit latin. Gjatë Luftës së Parë



FERHAT DRAGA

Botërore bashkëpunoi me austro-hungarezët për rekrutimin e rreth njëmijë luftëtarëve për t’i ndihmuar Austro-Hungarisë në frontin lindor. Më 1919, së bashku me të vëllanë, Nexhip Dragën, formuan organizatën politike “Xhemijet” (Bashkimi), e cila në zgjedhjet e vitit 1923 fitoi 14 ulëse në Parlamentin e Mbretërisë Jugosllave. Kur prishi marrëdhëniet me Partinë

Radikale Serbe të Nikolla Pashiqit, u arrestua, por më vonë u lirua. Njëkohësisht bashkëpunoi me Komitetin “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” në Shkodër. Pas vdekjes së vëllait, Nexhip Draga më 1921, u zgjodh kryetar i “Xhemijetit”. Në vitet ‘30 ishte aktiv në organizatën “Komuniteti Fetar Mysliman për Serbinë Jugore”, përmes së cilës u përpqo të promovonte idetë e bashkimit kombëtar. Me idenë e bashkimit kombëtar, bashkëpunoi me pushtetin italianë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe me krerët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ndërkaq më 1944 iu bashkua çetës nacionaliste e antikomuniste të Ukë Sadikut. Vdiq në rrethana të panjohura në Krelan të Gjakovës. (Mrika Limani)

DRAGA Nail (1957-). Gjeograf. Lindi në Draginë, komuna e Ulqinit. Shkollimin bazë e mori në Ulqin dhe në Prishtinë, ndërsa kreu studimet për gjeografi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) në Prishtinë (1980). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Zagrebit. Doktoratën e mbrojti në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji në vitin 1999. Në vitet 1983-1998 punoi asistent dhe ligjërues në FSHMN, në degën e gjeografisë. Një kohë ishte drejtor i shkollës fillore në Katërkollë të Ulqinit, ndërsa më pas ushtroi detyrën e drejtorit të Qendrës Kulturore në Ulqin. Ishte njëri nga themeluesit dhe kryetar i Shoqatës “Art-Club” të Ulqinit dhe kryeredaktor i revistës “Lemba”. Ka botuar disa libra: “Shqiptarët në Mal të Zi” (1994), “Gjurmë gjeografike” (1997), “Shpalime gjeografike” (2001), “Meditime për identitetin” (2005), “Kultura dhe shoqëria civile” (2009), “Intelektuali dhe paragjykimet” (2013). Ka marrë pjesë në tribuna, sesione, simpoziume dhe konferenca shkencore. (Hivzi Islami)

DRAGA Nexhip (1868-1921). Veprimtar i çështjes kombëtare shqiptare në fillim të shekullit XX. Lindi në Mitrovicë, në familjen e njohur Draga, me prejardhje nga Mojtiri i sanxhakut të Pazarit të Ri. Babai i tij, Ali Pashë Draga, ishte anëtar i këshillit të përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmin në Velesh dhe të lartin në Universitetin e Ankarasë, për ekonomi. Që nga viti 1896 kreu detyra administrative në Kratova e Velesh të Pazarit të Ri dhe në Shkup. Në prag të Lidhjes së Pejës u angazhua në veprimtari politike në Mitrovicë. Mbështeti



NEXHIP DRAGA

lëvizjen e turqve të rinj dhe më 1908 zgjidhet deputet i vilajetit të Kosovës në parlamentin turk. N. Draga mbështeti vendimet e Kongresit të Manastirit (1908) në mbrojtjen e shkollës dhe të gjuhës shqipe, të alfabetit latin për gjuhën shqipe, si dhe kundërshtoi me forcë alfabetin arab, të predikuar nga turqit e rinj. Ai kontribuoi për formimin e klubit arsimor kombëtar “Bashkimi” në Shkup, si dhe ishte veprimtar i shquar i klubit qendror në Stamboll. Punoi për futjen e gjuhës shqipe në Shkollën Normale, në Gjinnaz dhe në Shkollën Edukative të Shkupit. Më 1910 udhëhoqi luftën parlamentare për mbrojtjen e gjuhës shqipe, si dhe për demaskimin e ekspeditave ndëshkuese të Xhavit Pashës në Kosovë. Gjatë kryengritjeve të mëdha të viteve 1910-1912 ishte pjesëtar i shtabit drejtues. Në tetor të vitit 1912 u arrestua nga ushtria serbe në Shkup, bashkë me 14 politikanë të tjerë shqiptarë, përfshirë Hasan Prishtinën, duke ua pamundësuar pjesëmarrjen në Kuvendin Kombëtar të Vlorës. Më 1913 u lirua nga burgu dhe shoqëroi Hasan Prishtinën në Vlorë. Më pas u kthye në vendlindje dhe në Mitrovicë krijoi organizatën arsimore-kulturore “Bashkimi”, me emrin e cilës vepronte komiteti i fshehtë për Shqipërinë etnike, e kryesuar nga Hasan Prishtina. Më 1918 sëmuret dhe i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjike në spitalin e Vjenës. Më 1919 organizon dhe drejton parti-në politike “Xhemijet” (Bashkimi), me synim zbatimin e programit të Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Më 1920, si përfaqësues i kësaj partie, zgjidhet deputet i Parlamentit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene. Në fillim të vitit 1921 sëmuret përsëri dhe kryen një ndërhyrje tjetër kirurgjike në Vjenë, por pa rezultat. Vdiq në spitalin e Vjenës. (Endrit Musaj)

DRAGAJ Shaban (1958-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Klladërnice të Skënderajt. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në Mitrovicë, ndërsa Akademinë Ushtarake në Beograd (1981). Ishte oficer i Ushtrisë Jugosllave në Slloveni deri në vitin 1991. U largua nga ushtria dhe emigroi në Zvicër, ku mori pjesë në organizimet politike të mërgimtarëve. Në vitin 1998 u kthye në Kosovë

dhe u përfshi në radhët e UÇK-së. Kreu detyra me përgjegjësi në Zonën Operative të Shalës. Ishte zëvendëskomandant brigade në disa zona lufte, pastaj zëvendëskomandant i Brigadës "132 "Myrtë Zeneli", i Brigadës 121 "Ismet Jashari" dhe i Brigadës 112 "Arben Haliti". Mori pjesë në betejën e Loxhës, afër Pejës (1998). Pas luftës kreu shumë detyra me përgjegjësi në fushën e sigurisë. (Emin Musa)

DRAGASHI (SHARRI). Qytezë në skajin jugor të Kosovës dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Ndodhet 37 km larg nga Prizreni. Shtrihet në pjesën veriore të komunës



DRAGASHI

së Dragashit, ndërmjet dy regjioneve: Opojës dhe Gorës. Në pjesën juglindore kufizohet me Lubovishtin, në verilindje me Shajnen, në jug me Kukajinin dhe në veriperëndim me Kërstecin dhe Rapçën. Shtrihet në lartësi mesatare mbidetare 1,100 m. Qyteza e Dragashit ka lidhje të mira rrugore me rrugë të asfaltuara në të katër anët, pastaj disponon rrjetin e telekomunikimit, sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Sipërfaqja e territorit është 3.6 km², me dendësi të popullsisë prej 305 b/km². Si vendbanim përmendet në dokumentet e shkruara mesjetare dhe në defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Është vendbanim i vetëm i përzier në komunën e Dragashit ku jetojnë dy komunitete, shqiptarë dhe goranët. Është qendër administrative, politike, ekonomike, shëndetësore, arsimore e 35 fshatrave të komunës së Dragashit. Numri i popullsisë shënon rritje brenda periudhës 1948-2011. Derisa në vitin 1948 Dragashi kishte 408 banorë, në vitin 2011 ka 1,098 banorë. Në strukturën e aktiviteteve ekonomike dominojnë ato terciare dhe sekondare, si:

shërbimet dhe bankat, tregtia, industria e pakët etj. Avancimi i statusit administrativ i jep edhe atributet e qendrës arsimore dhe shëndetësore. Nga objektet dhe infrastruktura shoqërore ka administratën komunale, qendrën e mjekësisë familjare, gjykatën komunale, njësinë postare, shtëpinë e kulturës, bibliotekën, shkollën fillore dhe të mesme, tregun etj. Zhvillimi ekonomik mbështetet në industrinë e përpunimit të drurit, të tekstilit, tregtisë, shërbimeve hoteliere, si dhe të mbledhjes dhe përpunimit të frutave malore. (Hasim Kryeziu)

DRAGASHI (SHARRI) (komuna). Komunë në skajin jugor të Kosovës. Shtrihet në dy rajone, në atë të Opojës dhe të Gorës. Në veri kufizohet me komunën e Prizrenit, në juglindje dhe lindje me Maqedoninë, ndërsa në perëndim dhe jugperëndim me Shqipërinë. Është komunë tipike malore, me sipërfaqe 434,98 km². Zë afro 4% të territorit të Kosovës dhe 10% të Rrafshit të Dukagjinit. Në vitin 2011 në komunën e Dragashit u regjistruan 33,997 banorë, ndaj 20,140 banorë sa kishte në vitin 1948. Dendësia mesatare e popullsisë është 78 banorë në 1 km².

Në aspektin fiziko-gjeografik dallohet me diversitetin e peizazheve, me tipa të ndryshëm të relievit dhe me strukturën e diferencuar të ndërtimit të truallit. Territori i komunës kufizohet përmes ngritjeve të larta malore. Në veriperëndim, në kufi me Shqipërinë, ndodhen Koritniku (2262 m) dhe Kodra e Karanikollës (2409 m), Maje (2493 m) në lindje, Kryet e Kagid (2207 m) në veri të Brodit; në juglindje Vraca e Madhe (2536 m) dhe Kësula e Priftit (2075 m) në jugperëndim. Relievi i lartë dhe i copëzuar prej grykave dhe lugjeve ka kushtëzuar dominimin e klimës, hidrografisë dhe bimësisë specifike. Klima është submalore, me temperaturë mesatare vjetore 18.1°C. Dimrat janë të gjatë dhe relativisht të ftohtë, me temperaturë mesatare -0.4°C, derisa në pjesët e ulëta temperaturat janë 10°C. Reshjet janë më intensive në stinën e vjeshtës dhe pranverës, ndërsa reshjet e borës janë dukuri e zakonshme. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është mbi 800 mm. Rrjedha kryesore lumore është lumi i Plavës, i cili me degët e veta formon sistemin lumor që përfshin rreth 63 % të territorit të komunës. Në viset e larta malore ndodhen disa liqene akullnajore. Territori i komunës ka sipërfaqe të konsiderueshme të

tokave bujqësore. Nga 43,524 ha të sipërfaqes së përgjithshme të komunës, 33,903 ha ose 77.9% është tokë bujqësore. Komuna e Dragashit ka gjithsej 36 vendbanime të shtrira në rajonet e Opojës dhe të Gorës. Sipërfaqja e Opojës është 130 km², e cila bashkë me qytezën e Dragashit përfshin 30% të territorit administrativ të komunës me 19 fshatra. Sipërfaqja e Gorës është 305 km², ose rreth 70% e territorit me 16 fshatra. Derisa në Opojë jetojnë 19,262 banorë ose 56.7% e popullsisë, në Gorë jetojnë 13,637 banorë ose 40.1 % e popullsisë. Vendbanimet shtrihen në lugina dhe tarraca lumore, rrëzë shpateve të maleve. Janë kryesisht fshatra të grumbulluara dhe të ndara në lagje apo mëhalla. Komuna është tipike bujqësore-blegtorale. Sipërfaqet e mëdha të kullotave, peizazhet submalore të ndërthurura me veçori etnografike ofrojnë mundësi për valorizimin kompleksit turistik, i cili mund të bëhet një gjenerues i rëndësishëm i të ardhurave për komunitetin lokal. (Hasim Kryeziu)

DRAHMAT ILIRE. Shih: THESARI I ÇE-LLAPEKUT.

DRAJKOCI. Fshat në krahinën e Siriniqit, rreth 5 km në lindje të Shtërpcës dhe 19 km në jugperëndim të Ferizajt. Shtrihet në anën e djathtë të lumit Lepenc, pranë magjistrales Shtërpcë-Ferizaj. Lartësia mbidetare 800 m. Është vendbanim i tipit të grumbulluar. Si vendbanim përmendet në disa dokumente kishtarë mesjetare. Shpërngulja e popullsisë, sidomos asaj shqiptare ka sjellë deri te zvogëlimi i numrit të popullsisë. Në vitin 1921, Drajkoci kishte 156 banorë, në vitin 1948 kishte 218 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011) fshati kishte 106 banorë. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë blegtoria dhe bujqësia. Është bashkësi lokale ku gravitojnë vendbanimet: Firajë, Gotovushë, Kashtanjevë dhe Viqë. Nga objektet e standardit shoqëror ka stacionin shëndetësor, shtëpinë e kulturës, njësi tregtare etj. (Ramiz Cërvadiku)


DRAMA. Drama shqipe, në krahasim me gjinitë e tjera të artit, në kuadër të zhvillimit letrar shqiptar në Kosovë, nuk ka treguar avancim të kënaqshëm dhe nuk ka ecur paralelisht me format e konsoliduara në poezi dhe prozë. Është Josip Relat, nga Arbneshi i Zarës, i cili, ndër të tjera, boton te revista "Jeta e re" dramën "Nita" (1954) e cila ka për

tematikë shpërnguljen shqiptare nga Kraja në viset arbneshe të Zarës. Vlera e saj qëndron në aspektin historik të shfaqjes së artit dramatik si dhe latimin e arbërishtës në këtë formë letrare. Dramaturgë të tjerë, kryesisht të viteve '50, janë Xhemil Doda me dramën "Halit Gashi" (1955), Kristë Berisha me komedinë "Kryet e hudrës", botuar më vonë më 1973, Hivzi Sulejmani me dramën e realizmit kritik "Miu në xhep", (1958) Jusuf Kelmendi me "Rrëmuja" (1961) dhe "Tri drama" (1973), Muharrem Qena "Bashkëshortët" (1955) etj., të cilët, duke qenë prijatarë të kësaj forme artistike-skenike hapën rrugë për konsolidimin e saj në vitet '60-'70, kur në hapësirën kulturore të Kosovës dalin autorë të tjerë si Anton Pashku, Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Teki Dervishi, Beqir Musliu, Sabri Hamiti, Ymer Shkreli etj. Anton Pashku solli dramën e absurdit dhe antitotalitaritetit me veprat "Sinkopa" (1969) e "Gof" (1976), ndërsa Rexhep Qosja me librin dramatik "Mite të zhveshura" (1978) risemantizoi mitet biblike, sociale e etnike-nacionale qoftë edhe si mesazh për kohën e re. Azem Shkreli me dramën "Fosilet" (1968) dhe "Varri i qyqes" (1983) ndërton figurimin e ndërliqshëm të filozofisë së kohës dhe njeriut. Ndërsa Ymer Shkreli me trilogjinë dramatike me tematikë historike "Trilogji ilire" (1977) si formë e antidramës. Beqir Musliu, solli korpusin dramatik si sinkretizim formash e parabolash me burimësi në gamën e gjerë të simboleve në veprën e tetë dramave me titull "Shtrigani i Gjel Hanit" (1989). Teki Dervishi me veprat "Bregu i pikëllimit" (1985), "Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit" (1995), "Pranvera e librave" (1990), "Vojcehu" (1992) forcon dramën moderne në Kosovë me premisa të sinkretizimit të formave, ndërsa në rrafshin e ideve frymën e rrjetit të simbolikave ekzistenciale të njeriut. Edi Shukriu, ndërkaq, te dramën "Kthimi i Euridikës" (1986) dhe "Lkeni i Hasit" (1992) hyn në lojën artistike të meditacionit për jetën e vdekjen. Evolucionin e dramës shqipe në Kosovë e begatojnë edhe Musa Ramadani, Sabri Hamiti, Mehmet Kraja, Milazim Krasniqi e Haqif Mulliqi, të cilët realizojnë vepra të ndërliqshme, duke shfrytëzuar reminishencat historike. Kësaj plejade të dramaturgëve të Kosovës i janë bashkuar edhe autorët më të rinj, të cilët sprovajnë e provojnë struktura moderne e postmoderne dramatike. Prandaj drama shqipe, e nisur si strukturim elementar,

forcohet me eksperimentime të vlefshme në strukturën e saj duke integruar stilet më të ndërliqshme të realizimit dhe duke sjellë rrymat moderne e postmoderne si filozofi krijimtare. (Nysret Krasniqi)

DRANÇOLLI Bahri (1940-). Grafist. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit (1961). Kreu studimet për pikturë në Akademinë e Arteve Aplikative, në Universitetin e Beogradit (1967), ndërsa studimet pasuniversitare në Akademinë e Arteve në Shtutgart (1970). Mbaroi specializimin për grafikë në Munih në vitin 1973. Krijimtaria grafike e B. Drançollit është e ndërlidhur me pikturat dekorative, të cilat janë të realizuara në teknikën e akuatintës me ngjyrë. Në këtë teknikë realizoi ciklin më të arrirë “Reliktet”. Mbajti një sërë ekspozitash personale në galerinë “Stuckvilla” (1973), në Galerinë “Van Lear” (1974), në “Kunstverein Rosenheim” (1975), “Kunstsalon” dhe në “Galeria Kieslich” të gjitha këto në Munih të Gjermanisë, pastaj në “Galeriastudio M” në Bamberg (1976) në Galerinë “Kunstwerkstatt” (1977) në Darmshtad, në Galerinë “Hesler” (1978) dhe në Galerinë “Marsyas” po në Munih (1979). Jeton dhe vepron në Munih të Gjermanisë. (Fatmir Krypa)

DRANÇOLLI Fejz (1949-). Historian i artit. Lindi në Pejë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet në Universitetin e Beogradit, ndërkaq studimet e magjistraturës



FEJAZ DRANÇOLLI

dhe të doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi si mësimdhënës, më pas gazetar dhe kritik i artit figurativ në rubrikën e kulturës në gazetën “Rilindja” në Prishtinë. Për shumë vjet punoi në Entin Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë (më vonë Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, IKMM). Ishte sekretar i shoqatës së konservatorëve të ish-Jugosllavisë dhe një kohë edhe drejtor i IKMM-së. Udhëhoqi edhe sektorin e hulumtimit shkencor dhe të dokumentacionit në këtë institut. Realizoi dhe udhëhoqi një numër projektsh për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore-

materiale, si dhe disa projekte për trashëgiminë kulturore shqiptare të Kosovës të shkatërruar gjatë luftës së viteve 1998-1999. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe i disa monografive, si: “Kulla shqiptare” (2001), “Rrënimi i kullës shqiptare” (2005), “Trashëgimia monumentale në Kosovë” (2011), “Monumentet e shkatërruara në Kosovë 1998-1999” (2015) etj. Mori pjesë me kumtesa në shumë simpoziume dhe konferenca shkencore dhe realizoi një sërë ekspozitash për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës gjatë viteve të luftës së fundit 1998-1999. (Gazmend Rizaj)

DRANÇOLLI Ismet (1944-). Piktur. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe Shkollën e Mesme të Artit. Kreu Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd më 1971. Si student i dalluar mori bursën “Moshë Pijadë”. Punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Është i njohur si krijues i kompozicionit abstrakt të projektuar në materiale dhe shprehje të formës konkrete të një realiteti të brendshëm në frymën aplikative, stilistike e moderne. Organizoi disa ekspozita personale dhe, si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, mori pjesë në disa ekspozita kolektive, si në Varazhdin (1972), Beograd (1975), Prishtinë (1976), Poreç (1977), Pejë (2013) etj. Është fitues i mirënjohjeve dhe çmimeve: në Beograd, për pllakatin “Jezh” (1969); në Pejë, për logon e fabrikës “Ramiz Sadiku” (1978); pastaj në Raciboz (Poloni); në Bienalen III Ndërkombëtare (2000) në Pejë; në manifestimin “Flaka e Janarit” (2002) etj. (Hajrush Fazliu)

DRANÇOLLI Jahja (1946-). Historian, medievalit, profesor universiteti. Lindi në Pejë. Studimet për histori i mbaroi në Prishtinë (1971). Studimet pasuniversitare dhe të doktoratës në fushën e medievalistikës i vazhdoi në Zarë dhe Dubrovnik. U magjistrua në Zarë dhe u doktorua në Prishtinë (1984). Në periudhën 1971-1980 punoi në gjimnazin “11 Maji” në Pejë, më pas në Institutin e Historisë të Kosovës (1980-1993). Më 1993 u zgjodh profesor inordinar në degën e historisë të



JAHJA DRANÇOLLI

Fakultetit të Filozofisë në Prishtinë, u avancua në profesor ordinar dhe një kohë udhëhoqi departamentin në tri nivele të studimit. Është njëri ndër themeluesit e departamentit të historisë në Universitetin e Tetovës (1996-2011). Ndërkohë bëri studime postdoktorale dhe hulumtime arkivore nga lëmi i medievalistikës, paleografisë, diplomatikës, egdotikës, heraldikës sidomos në arkiva, biblioteka e muze në Ankona, Dubrovnik, Kotorr, Padova, Romë, Stamboll, Venedik, Vjenë, Zagreb, Zarë etj. Ishte drejtori i parë i Institutit Arkeologjik të Kosovës të sapothemeluar, të cilin e udhëhoqi nga viti 2003 deri në vitin 2009. Gjatë kësaj periudhe realizoi disa projekte kërkimore-shkencore nga lëmi i arkeologjisë dhe i shkencave ndihmëse të historisë. Publikoi një sërë punimesh shkencore të botuara në revista profesionale brenda dhe jashtë vendit dhe mori pjesë në shumë simpozium dhe konferenca shkencore. Gjatë kohës që ishte drejtor i Institutit të Arkeologjisë ishte pjesëmarrës në një sërë projektesh nga fusha e historisë dhe trashëgimisë kulturore. Ka botuar disa monografi shkencore, nga të cilat veçohen: “Gjin Gazulli, astronom dhe diplomat i shekullit XV” (1984), “Raguzanët në Kosovë (prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455)” (1986), “Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” (2001), “Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës” (2008) etj. Është kontribues në Enciklopedinë botërore të arkeologjisë (Encyclopedia of Global Archaeology) (2014) me studimin “Kosova: Trashëgimia arkeologjike” (Kosova: Archaeological Heritage). (Faik Sahiti)

DREJTA Selim (1883-1951). Hoxhë, pedagog, myderriz dhe poet. Lindi në Vushtrri. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. Mbaroi studimet në Shkollën Normale turke në Shkup (1904). Punoi si mësues në mejtepet e Vushtrrisë nga viti 1904 deri në vitin 1912 dhe më pas si pedagog në Medresenë “Gazi Ali begu” në Vushtrri, në të cilën ishte njëkohësisht edhe drejtor i saj (1913-1941). Ishte anëtar i Kuvendit të Ulema Mexhllisit me seli në Shkup në kohën kur në këtë institucion përkrahësit e vijës së Ferhat bej Dragës diskutonin dhe mbronin të drejtat e shqiptarëve në kuadër të Mbretërisë Jugosllave. Ishte anëtar i organizatës politike e kulturore-arsimore “Bashkimi”, formuar nga Hasan Prishtina në Mitrovicë më 1915. Në vitin 1918 pushteti serb e burgosi

për shkak të aktivitetit të tij politik në kohën e sundimit austro-hungarez në Kosovë. Shkroi kryesisht në gjuhët orientale, por ka lënë edhe poezi në gjuhën shqipe me alfabet arab. Në shkrimet e tij nënshkruhej me pseudonimin poetik “Sâmi”. Ka lënë shumë vepra në dorëshkrim. Shkroi edhe një sërë artikujsh për gazetata në gjuhën turke, që dilnin në Shkup. (Nehat Krasniqi, Sadik Mehmeti)

DREJTORITË E ARSIMIT. Organe kompetente komunale, të cilat udhëheqin, menaxhojnë dhe koordinojnë arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm (të ulët dhe të lartë) dhe licencojnë institucionet e arsimit publik parauniversitar në komunë. Merren me punësimin e mësimdhënësve dhe të personelit tjetër në arsim, me zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore, me pagesën e stafit arsimor, me planifikimin dhe mbikëqyrjen e arsimit parauniversitar, me pranimin dhe regjistrimin e nxënësve në shkollë, si dhe me evidentimin e të dhënave të tyre, me nxitjen dhe promovimin e mundësive të barabarta për arsim dhe me respektimin dhe afirmimin e të drejtave të komuniteteve për arsimim. (Riza Brada)

DRELAJ. Fshat në komunën e Pejës, 15 km në perëndim të qytetit. Është fshat i thellë malor përgjatë lumit Bistrica e Pejës. Shtrihet në lartësi mbidetare 1,520 m. Nga fizionomia i përket vendbanimeve të tipit të shpërndarë. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,579 ha, shumica me pyje dhe livadhe. Popullsia merret me blegtori ekstensive dhe turizëm malor. Është vendbanim i vjetër, i cili në sallnamet osmane të vitit 1900 është regjistruar me emrin Rugova Antike (Rugova e Vjetër). Në defterin e Sanxhakut të Shkodrës (1485) kishte 69 shtëpi, ndërsa në defterin tjetër të Sanxhakut të Shkodrës (1582) kishte 84 shtëpi. Në vitin 2011 Drelaj kishte 74 banorë, ndaj 116 banorë sa kishte pasur në vitin 1921. Drelaj është vendbanim i Rugovës së poshtme dhe qendër e fshatrave përreth. (Bajram Kafexholli)

DRENASI (GLLOGOCI). Qytet në Drenicë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër, rreth 32 km larg Prishtinës. Shtrihet në qendër të territorit të komunës, në anën e majtë të lumit Drenica. Lartësia mbidetare rreth 580 m. Në anën juglindore të qytetit rrjedh lumi Drenica, ndërsa në jug dhe jugperëndim rrjedh lumi i Vërbocit, degë e majtë e lumit Drenica.



DRENASI

Nëpër këtë qytet kalon rruga hekurudhore Prishtinë-Pejë, e cila prehet me magjistralen Mitrovicë-Skënderaj-Drenas-Komoran, duke i mundësuar kështu lidhje të mira komunikimi me qendrat e tjera të Kosovës. Në dokumentet e shkruara përmendet si vendbanim në defterin kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1530 dhe të vitit 1566-74 me emrin Gulogofça. Ky vendbanim është i regjistruar edhe në një hartë austriake të vitit 1689. Është qendër komunale, në të cilën gravitojnë 35 vendbanime. Ndërtimi i hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë në vitin 1936 ndikoi në zhvillimin urban dhe ekonomik të Drenasit. Në vitin 1946 Drenasi ishte seli për rrethin e Drenicës, ndërsa në vitin 1981 shpallet qytet dhe qendër kryesore administrative. Në vitin 1921 kishte 65 shtëpi me 211 banorë, në vitin 1948 kishte 558 banorë, në vitin 1971 kishte 1,343 banorë, në vitin 1981 kishte 2,440 banorë dhe në regjistrimin e fundit të vitit 2011 kishte 6,143 banorë. Deri në vitet '80 të shekullit XX degë kryesore ekonomike ishte bujqësia. Zhvillimi i industrisë merr hov në vitet '80, me hapjen e Kombinatit xehetaro-metalurgjik "Ferronikeli" dhe fabrikës së konfeksionit "Kluz", të cilat kishin numër të madh të të punësuarve. Krahas industrisë, u zhvillua edhe bujqësia dhe zejtaria. Prodhimtaria industriale e bujqësore, transporti hekurudhor dhe automobilistik patën ndikim të madh në zhvillimin e kësaj zone. Gjatë viteve '80 të shek. XX u ndërtuan shumë objekte arsimore, shëndetësore, kulturore, afariste dhe banesore, duke i dhënë kështu Drenasit tiparet e qendrës urbane. Në vitet '90 të shekullit të kaluar ekonomia u shkatërrua. Gjatë luftës së vitit 1998-99 qyteti u dëmtua rëndë. Sot në ekonominë e këtij qyteti dominon tregtia, zejtaria dhe industria.

Pas privatizimit, është riaktivizuar fabrika e Ferronikelit, e cila ka rreth 600 punëtorë. Së fundi Drenasi përjetoi zhvillim të ndjeshëm të infrastrukturës. U ndërtuan shumë rrugë të reja, objekte banesore, shkolla, objekte sportive, kulturore etj. (Ramiz Cërvadiku)

DRENASI (GLLOGOCI) (komuna). Shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, ndërmjet dy rajoneve të mëdha gjeografike, Rrafshit të Kosovës në lindje dhe Rrafshit të Dukagjinit në perëndim. Ka sipërfaqe prej 276 km² dhe përfshin 2.66% të territorit të Kosovës. Nëpër territorin e kësaj komune në drejtimin lindje-perëndim kalon hekurudha Prishtinë-Pejë dhe autostrada Prishtinë-Prizren, të cilat kryqëzohen me magjistralen Skënderaj-Drenas-Komoran- Carralevë. Kjo e bën atë udhëkryq dhe një të rëndësishme ndërmjet qendrave të mëdha rajonale të Kosovës dhe më gjerë. Komuna e Drenasit në lindje kufizohet me Fushë-Kosovën dhe Obiliqin, në verilindje me Vushtrrinë, në veri dhe veriperëndim me Skënderajn, në perëndim me Klinën, në jugperëndim me Malishevën dhe në juglindje me Lipjanin. Në relievin e kësaj komune malet zënë rreth 27% të sipërfaqes me lartësi mbidetare mbi 700 metra. Malet shtrihen në anën lindore dhe perëndimore të territorit të komunës, kurse në mes tyre shtrihet fusha e Drenicës me lartësi mbidetare prej 550-650 metra, e cila përfshin rreth 73% të kësaj komune. Në malet lindore bëjnë pjesë: Çiçavica, mali Vasilevës, Goleshi dhe Blinaja, kurse në malet perëndimore: mali Berisha, Kosmaqi, mali i Tërstenikut dhe Kodra. Maja më e lartë është në malin e Berishës me 1,024 metra. Klima është kontinentale, me reshje mesatare vjetore 600-700 mm. Hidrografia nuk është e pasur, ndërsa lumi kryesor është Drenica, që buron nga malet e Carralevës. Gjatësia e këtij lumi nëpër territorin e komunës është 24 km. Qendër urbane dhe administrative e kësaj komune është Drenasi. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore numri i popullsisë pati rritje të vazhdueshme. Në vitin 1948 kishte 16,951 banorë, në vitin 1961 kishte 22,044 banorë, në vitin 1981 kishte 40,514 banorë dhe në regjistrimin e fundit (2011) komuna e Drenasit kishte 58,531 banorë. Komuna ka 35 vendbanime me dendësi mesatare të popullsisë 212 b/km². Deri në vitet '70 të shek. XX komuna ishte tipike agrare, me bujqësi

ekstensive si degë kryesore të ekonomisë. Në vitin 1961 numri i të punësuarve në sektorin primar ishte 87%, sektorin sekondar 4% dhe në sektorin terciar e kuartar 9%. Zhvillimi i hovshëm ekonomik në këtë komunë ka filluar në vitet '70 e posaçërisht në vitet '80 të shek. të kaluar, me aktivizimin e fabrikës së Ferronikelit dhe disa fabrikave të tjera, ku u punësuan një numër i madh i njerëzve dhe me këtë ndryshoi edhe tipi i strukturës ekonomike. Rritje shënoi sektori sekondar (industria e xehetaria), me pjesëmarrje prej 54.7% të të gjithë të punësuarve. Prej vitit 1990-1999 ekonomia pësoi rënie dhe nuk ka ndryshuar shumë edhe pas luftës. Gjatë luftës së vitit 1998-99, kjo komunë kishte pësuar dëme të mëdha, si materiale ashtu edhe në njerëz. Në strukturën ekonomike sot dominon bujqësia. Në fillim të vitit 2007, pas privatizimit, është riaktivizuar kombinati xehetaro-metalurgjik "Ferronikeli". Në funksion janë disa gurore dhe subjekte të vogla prodhuese. Përveç bujqësisë dhe industrisë, degë e rëndësishme është edhe tregtia. (Ramiz Cëravadiku)

DRENI Abdullah Pashë (1820-1878). Lindi më 1820 në Gjakovë. Shërbeu në ushtrinë e Perandorisë Osmane, ku u dallua sidomos në luftën e Plevnës, një nga betejat e mëdha të luftës ruso-turke (1877-78). Pas kësaj lufte mori titullin pashë. Në fillim ishte ndër veprimtarët e dalluar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. U zgjodh kryetar i parë i degës së Gjakovës. Me ardhjen e Mehmet Ali Pashë Maxharrit në Kosovë, i cili i kërkoi mikpritjen Abdullah Pashë Drenit, u krijua preteksti i përçarjes së madhe midis kryengritësve shqiptarë dhe udhëheqjes së Degës. Ky veprim i Abdullah Pashë Drenit e dëmtoi rëndë prestigjin e Lidhjes. Si pasojë e këtij veprimi, në Luftën e Gjakovës në shtator 1878 pati shumë të vrarë e të plagosur. Në mesin e të vrarëve ishin edhe Mehmet Ali Pashë Maxharri, Abdullah Pashë Dreni, Shaqir Curri, Bajram Aga dhe shumë figura të tjera të Lëvizjes. (Alban Dobruna)

DRENICA. Trevë etnogeografike në Kosovë. Ka pozitë qendrore në mes të fushëgropës së Dukagjinit në perëndim dhe të Kosovës në lindje. Nga fushëgropa e Dukagjinit e ndajnë mali Drenica dhe Kosmaç, ndërsa nga fushëgropa e Kosovës malet Çiçavica dhe Golesh. Drenica ka një shtrirje gati

meridionale, duke filluar nga Mali i Thatë në veri dhe deri te mali i Carralevës në jug. Relievi është kodrinor-malor. Pjesa jugore pjerrësohet në drejtim të veriut, në drejtim të rrjedhjes së lumit Drenica, ndërsa pjesa veriore në drejtim të jugut, në drejtim të rrjedhës së lumit të Vërbocit. Lartësia mbidetare sillet nga 550-700 m. Pjesët e ulëta, fushore, janë të ndërtuara nga shkëmbinjtë e pliocen-kuaternarit, të cilat përfaqësohen nga argjilat, rërat dhe zhavorri, me shtresa të holla të qymyrit (linjit), ndërsa pjesët anësore nga formacionet flishore. Në aspektin gjeografik, Drenica ndahet në atë veriore (e epërme) dhe jugore (e ulët). Drenica e epërme karakterizohet me reliev me kontraste të vogla, me lartësinë më të madhe në malin Çiçavica, ndërsa Drenica e ulët karakterizohet me kontraste morfologjike më të shprehura. Nëpër fundin e fushëgropës rrjedh lumi Drenica, i cili e ka thelluar luginën e tij në shkëmbinjtë e rinj në gjatësi rreth 25 km. (Shpejtim Bulliqi)

DRENICËS (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Cilësohet e folme me pak dallime nga të folmet e tjera përreth. Ka një inventar prej 17 fonemash zanore dhe 27 fonemash bashkëtingëllore. Tingulli ë nuk hyn në raporte kundërvënëse, ndërsa o-ja del e nazalizuar vetëm në një numër të vogël fjalësh: *thōni, ftōni*. Të gjatat dhe të shkurtrat krijojnë kundërvënë: *vrās, plās, vjël, shtrōj - vrās, plās, vjël, shtrōj*, njëjtë siç krijojnë edhe zanoret hundore: *āsht (folje) - asht-i (emër); sēne (gjësende) - sene (viti)*. Disa fjalë me origjinë orientale ruajnë theksin në rrokjen e fundit: *havá, sefá, terzí*. Fonema *a* në pozitë para bashkëtingëlloreve nuk labializohet. Përrjashtim paraqesin rastet në foljet ndihmëse *jam* dhe *kam*, të cilat shqiptohen me *u: jum* ardh; *jum shkū, kum qit pūshk*. Ndërsa zanorja *e* del me dy reflekse: në pjesëzën *me* të infinitivit gegë kalon në *a: ma punu(e)* dhe refleksi i dytë anon kah një *e* e nazalizuar: *mē punu(e)*. Fonema *y* shpesh alternohet në *i*, ndërkohë që në zona të caktuara të kësaj të folmeje hapet më tej dhe krijon grupin zanor *ie: shiena* (për shira); *briena* (për bri). Tingulli *sh* shpesh këmbetet me tingullin *ç: çkruj, çpeshtoj*. Diftongjet *ie, ue* dhe *ye* janë reduktuar në elementin e parë, ndërsa është ruajtur në pozicionin nistor të fjalës grupi i vjetër *oe: droe, voe*. Është

zhdukur dallimi nyjetimor dhe fonologjik midis palataleve *q-g/* dhe *ç-xh*. Vibrantet *r-R* ruajnë tiparet kundërvënese. Në këtë të folme ruhen emrat e gjinisë asnjane, ndërsa emrat mashkullore: *shëndet-i, libër-i* dalin në gjininë femërore: *shnet-a, libër-a*. Përdoret rasi *thirrore* me pjesëzën *o* për emrat e gjinisë mashkullore dhe me *oj, moj* dhe *mori* për emrat e gjinisë femërore. Përemri vetor *unë* del në 3 trajta: *u, un* dhe *une*. Foljet në të tashmen e dëftores shumësin e bëjnë me mbaresën *-um: lahum, rrahum, krehum*. Drenica shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo zonë ka mbi 100,000 folës sipas regjistrimit të fundit. (Haki Hysenaj)

DRENOCI. Fshat në komunën e Deçanit, 3 km në jug të qytetit. Shtrihet përgjatë rrugës Deçan-Gjakovë, në lartësi mbidetare 575 m. Është vendbanim i tipit të dendur. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 556 ha, nga e cila 70% janë ara, të tjerat livadhe dhe pyje. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori ekstensive. Kultivohen drithërat, perimet etj. Vendbanimi del të jetë shumë i vjetër. Në dokumentet e shkruara përmendet me emrin Drenofça. Me këtë emër e hasim në defterin kadastral të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Në defterin e sanxhakut të Shkodrës i varur nga Peja të vitit 1582, figuron si vendbanim me gjithsej 8 shtëpi. Fshati ka kohë që është përfshirë nga valët e emigrimit, kryesisht në drejtim të qendrave urbane dhe jashtë vendit. Megjithatë, popullsia e fshatit ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2011 Drenoci kishte 1,046 banorë, ndaj 611 banorë në vitin 1921. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare dhe shërbyese etj. (Bajram Kafexholli)

DRESHAJ Ismail (1951-). Mjek, internist, profesor universiteti. Lindi në Nabërgjan të Pejës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pejë. I mbaroi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 1975. Pas diplomimit angazhohet në procesin mësimor në Institutin e Fiziologjisë Patologjike të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe magistraturën i kreu




ISMAIL DRESHAJ

në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1981). Vitet 1983-1985 i kaloi në Universitetin e Harvardit në Boston, ku punoi në laboratorin e fiziologjisë së frymëmarrjes. Tezën e doktoratës e mbrojti në vitin 1988 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. U zgjodh docent i lëndës së fiziologjisë patologjike dhe në periudhën 1976-1983 njëkohësisht punoi në njësinë nukleare, ndërsa pas kthimit nga Amerika (1985-1991) në njësinë respiratore të Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 1991 përjashtohet nga puna nga masat e dhunshme serbe dhe po atë vit shkoi në Universitetin e Klivlendit (Ohio, SHBA), ku bashkë me akademik Musa Haxhiun bënë kërkime të frytshme në kontrollin e frymëmarrjes. Më pas kreu specializimin për mjekësi interne dhe më 2004 u zgjodh asistent profesor në Spitalin Universitar të Klivlendit. Në këtë qendër është zgjedhur disa herë mësim-dhënës i vitit dhe "Master clinician". Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore të publikuara në revista të njohura profesionale. I. Dreshaj rregullisht e viziton Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku mban ligjërata me interes për studentët dhe pedagogët e këtij fakulteti, viziton laboratorët dhe jep këshilla për punë eksperimentale. (Avdyl Krasniqi)

DREZGIQ (Drezgic) Petar (1914-1980). Agronom, profesor universitar, akademik. Lindi në fshatin Jameni të komunës Shid të Vojvodinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Shabac, studimet e rregullta dhe tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Pylltarisë të Universitetit të Beogradit (1956). Caktohet me detyrë drejtor i Institutit të Bujqësisë në Pejë (1951-1957). Kontribuoi në organizimin e hulumtimeve shkencore në lëmin e bujqësisë kosovare. Në këtë Institut u mor me studimin shkencor nga lëmi i meliorimeve të tokave acidike dhe të atyre me produktivitet të ulët të Kosovës. Zgjidhet profesor në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit (1961) dhe njëherësh kreu edhe detyra të tjera në institucionet arsimore dhe shkencore të Vojvodinës (dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe rektor i Universitetit të Novi-Sadit). Publikoi punime shkencore dhe profesionale. Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Vojvodinës. (Bashkim Kabashi)

DRINI I BARDHË. Lumë në pjesën perëndimore të Kosovës. Rrjedh nëpër Rrafshin e Dukagjinit, që njëherësh paraqet lumin kryesor



BURIMI I DRINIT TË BARDHË, NË RADAVC

të tij. Buron nga gurra e Radavcit, në rrëzën e malit të Rusolisë, në lartësi mbidetare 580 m. Prurja mesatare vjetore në gurrën e Radavcit është 5 m³/sek. dhe paraqet burimin më të fuqishëm ujqor në Kosovë. Pellgu ujëmbledhës i Drinit të Bardhë shtrihet në Kosovë dhe në Shqipëri. Sipërfaqja e përgjithshme është 4,964 km², kurse në Kosovë gjenden 4,669 km² ose rreth 90% e pellgut. Gjatësia e lumit Drini i Bardhë është 117 km, ndërsa në Kosovë është 108 km i gjatë. Drini i Bardhë, me degët e tij, mbledh ujërat e pjesës lindore të Bjeshkëve të Nemuna (Bistrica e Pejës, Deçanit, Lloqanit, Ereniku), të pjesës jugore të malit Mokna (lumi i Istogut, Klina), të shpateve veriore dhe veriperëndimore të Maleve të Sharrit (Lumëbardhi i Prizrenit, Toplluha, lumi i Plavës), të shpateve veriore të maleve të Hasit dhe të shpateve perëndimore të vargut malor të Maleve Qendrore: Drenica, Kosmaçi (Mirusha).

Për shkak të rrethinës malore, klimës më të lagësht, ujëmbledhësi i Drinit të Bardhë karakterizohet me rrjet të dendur lumor. Dendësia më e madhe është në degët e djathta (Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, Ereniku) sesa në degët e majta (Klina, Mirusha, Toplluha). Rrjetin lumor të Drinit të Bardhë e përbëjnë 953 rrjedha të përhershme dhe të përkohshme.

Në ujëmbledhësin e Drinit të Bardhë pasqyrohen kontrastet morfologjike, klimatike, reshjet atmosferike, rrjedhjet ujore dhe zonaliteti vertikal i bimësisë. Pellgu i Drinit të Bardhë karakterizohet me amplitudat më të mëdha hipsometrike në Kosovës. Pellgu shtrihet nga pika më e ulët e Kosovës prej 273 m (dalja e Drinit të Bardhë në Shqipëri) deri te maja më e lartë e Kosovës, Gjeravica (2,656 m). Rrje-

dhja e ujërave të degëve lumore nga Bjeshkët e Nemuna dhe Sharri ka ndikuar në krijimin e grykave lumore (gryka e Rugovës, e Deçanit, e Erenikut, e Shushicës, e Lumëbardhit të Prizrenit etj.), që në disa raste kanë formë kanionike. Gjatë rrjedhjes përgjatë Rrafshit të Dukagjinit, duke eroduar shkëmbinjtë gëlqerorë të moshës së kretakut, ka krijuar një luginë epigjenetike (gryka e Gradishës, Ura e Fshejtë). Drini i Bardhë është lumë kryesisht fushor. Rënia mesatare e lumit është 2.9 m/km. Sasia mesatare e reshjeve në pellgun e Drinit të Bardhë lëviz nga 700 mm në pjesët fushore deri në 1,800 mm në zonat e larta malore, ndërsa mesatarja e gjithë pellgut është 836 mm. Koeficienti i rrjedhjes është 0.51, vlera e modulit të rrjedhjes luhatet ndërmjet 45 l/sek/km² në pellgun e Bisticës së Deçanit dhe 4 l/sek/km² në pellgun e Klinës dhe Toplluhës. Prurja mesatare vjetore në Vërmicë (kufiri Kosovë-Shqipëri) është 56.6 m³/sek. Prurjet maksimale janë në muajin maj (90.8 m³/sek), ndërsa minimale në muajin gusht (13.5m³/sek). Regjimi i rrjedhjes së Drinit të Bardhë është nivalo-pluvial (borë-shi). Prej dhjetorit deri në maj rrjedh 70% e prurjes, prej qershorit deri në nëntor rrjedh 30% e prurjes mesatare vjetore. Prurja më e madhe në muajt e pranverës (maj) lidhet me shkrirjen intensive të borës në zonat e larta malore të Bjeshkëve të Nemuna dhe Sharrit.

Në përmasa të Gadishullit Ballkanik, pellgu i Drinit të Bardhë veçohet si trevë e pasur me ujë, me tokë pjellore, biodiversitet të larmishëm, kullota të begatshme, me peizazhe natyrore të bukura. Në afërsi të Kukësit, Drini i Bardhë bashkohet me Drinin e Zi, duke formuar lumin Drin, ujërat e të cilit rrjedhin në Shqipëri, në drejtim të detit Adriatik. (Valbon Bytyçi)

DRINI Nybevetë (1932-2014). Mësuese veterane. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e vijoi në Burrel, Shkodër e Kolgecaj, progjimnazin në Prizren e Prishtinë, ndërsa shkollën normale në Gjakovë. Si mësuese filloi të punojë në vitin 1949, në një shkollë fillore në Prizren, pastaj në shkollën fillore "Vuk Karaxhiq" në Prishtinë, ku ishte edhe mësuese e ushtrimorese së Shkollës Normale në këtë qytet. U angazhua edhe në arsimin dhe emancipimin e femrës, në kurse kundër analfabetizmit, në kurse shëndetësore etj. Mori çmime dhe mirënjohje. (Afërdita Deva-Zuna)

DRINI Sylejman (1914-1994). Gjuhëtar, albanolog, përkthyes. Lindi në Prizren. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Shkodër, ndërsa studimet në Beograd. Punoi



SYLEJMAN DRINI

si mësues. Në vitet 1941-1944 ishte drejtor shkollë në Prizren. Nga viti 1945 mësimdhënës i gjuhës shqipe në gjimnazin e Prishtinës. Ishte redaktor i NGB "Rilindja" në Prishtinë. Ishte anëtar i komisionit që përpiloi projektin e rekomandimeve për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në Konferencën gjuhësore II dhe III. Ishte gjithashtu pjesëmarrës në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës më 1968 dhe në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 në Tiranë. Punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në sektorin e leksikografisë (1975-979). Është bashkautor i "Fjalor serbokroatisht-shqip" (1974), "Fjalor shqip-serbokroatisht" (1981), "Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore" (1982), "Fjalor terminologjik serbokroatisht-shqip" (1961) etj. Autor studimesh, trajtesash, artikujsh, recensionesh në revista të Kosovës. Përktheu nga serbokroatishtja librin "Drejtimit në linguistikë" (M. Iviq) dhe një numër veprash letrare. (Naim Berisha)

DRUGDHENDJA DHE GURGDHENDJA.

Drugdhendjet janë zburime në mjedisë të banesës, në enë ose orendi të familjes, apo në mjetet dhe veglat e punës. Te ne u zhvillua kryesisht në vise kodrinore e malore të pasura me pyje. Objektet prej druri, si: kërraba e bariut, luga, furka, fyelli, stoli, karrigia, djepi etj., bëheshin për të plotësuar nevojat e jetës familjare. Më vonë drugdhendja u zhvillua edhe si mjeshtri profesionale. Punimet zbukurorëshin me motive të frymëzuara nga natyra ose me simbole të mitologjisë shqiptare. Ndërkaq, gurgdhendja kishte funksion ndërtime: shtëpi banimi, mure të larta rrethuese mbrojtëse, kështjella dhe kala. Nga koha e ilirëve janë ruajtur deri në ditë të sotme shumë vepra të bëra prej gurit, si ndërtesa me porta, me harqe të gdhendur etj. Ilirët e kanë punuar gurin edhe për të bërë vegla të ndryshme për punë, armë për luftë ose përkujtimore për të vdekurit e tyre. Në popull është ruajtur tradita e gjatë dhe e moçme e punimit të gurit. Mjeshtrit

popullorë gurskalitës kanë lënë vepra të shumta punimesh në gur, oxhaqe, qemerë dyersh dhe dritaresh, gurë varresh, kroje, përkushtimore të ndryshme me motive të gdhendura në formë bimesh, kafshësh ose simbolesh të ndryshme. (Angjelina Hamza)

DUBOVA Isuf (1909-1981). Veprimtar anti-komunist, luftëtar për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lindi në fshatin Gadish të Gjilanit. Si i ri kundërshtoi me armë pushtetin e Mbretërisë Jugosllave. Pasi kreu një kurs ushtarak më 1941, u angazhua si oficer i xhandarmërisë shqiptare deri më 1944. Emërohet komandant i stacionit policor në fshatin Hajnoc të Kamenicës dhe më pas në Babush të Ferizajt. Ishte kundërshtar i lëvizjes komuniste dhe i bashkëpunimit me komunistët serbë e jugosllavë. Në periudhën qershor-nëntor 1944 organizoi njësitë vullnetare shqiptare, të komanduara nga Fuad Dibra, Adem Gllavica, Idriz Hajrullahu, Hysen Tërpeza etj., në mbrojtjen e kufirit të Kosovës Verilindore nga njësitë partizane. Pas rikthimit të pushtetit jugosllav në Kosovë (nëntor 1944) iu bashkua forcave politike dhe ushtarake që luftuan me armë pushtetin komunist. Në fund të vitit 1945, së bashku me vëllanë, Musliun dhe disa bashkëlufëtare, iku në Greqi. Në vitin 1948 kaloi në Turqi, në Stamboll, mandej jetoi në qytetin Denizli afër Adanës. Zhvilloi aktivitet politik në mbështetje të Kosovës dhe të bashkimit kombëtar. (Adem Murati).

DUBOVCI Valentina (1981-). Aktore. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Drenas. Studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet "Pallati i ëndrrave", "Magjistari nga Ozi", "Ku është populli", "Muzgu i lirisë", "Orestia", "Në kërkim të daljes" dhe "Motrat Silikoni". Në Teatrin "Dodona" luajti në shfaqjen "Fundi i lojës". Ndërkaq në Vjenë (Austri) luajti në shfaqjet: "Orferu në ferr" (Orpheus in der unterwelt) dhe "Rrëmbimi i fëmijëve" (Entführung). Luajti edhe në disa filma të metrazhit të gjatë, si: "Anatema", "Etjet e Kosovës" etj. Jeton dhe punon në Vjenë. (Erson Zymberi)

DUGOLLI Bujar (1969-). Historian, mësimdhënës universiteti. Lindi në Nekoc, komuna e Drenasit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Drenas. Fakultetin,



BUJAR DUGOLLI

studimet pasuniversitare dhe ato të doktoratës i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Ishte njëri nga udhëheqësit e lëvizjes studentore në Kosovë gjatë viteve 1997-1999. Për shkak të aktivitetit të tij politik

u ndoq dhe u arrestua nga policia serbe. Ishte pjesë e delegacionit negociator të Kosovës në Konferencën e Rambujesë (1999), ndërsa në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, pas procesit të Rambujesë, ishte ministër i Rinisë dhe i Sporteve (1999-2000). Nga dhjetori i vitit 2004 deri në janar të vitit 2008 ishte ministër i Tregtisë dhe i Industrisë në Qeverinë e Kosovës dhe deputet i Kuvendit të Kosovës në tri legjislatura (2001-2010). Është autor i disa monografive shkencore (“Një Tetori i kthesës - Lëvizja studentore 1997-1999”, “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe prej 1878-1912”, “Drenica në kthesën historike të Ballkanit 1908-1913” etj), si dhe i një numri shkrimesh të botuara në revista shkencore të vendit dhe ndërkombëtare. (Muhamet Qerimi)

DUHANPIRJA. Duhani (*Nicotiana tabacum*, L.) është bimë barishtore njëvjeçare, e familjes së Solanoreve (Solanaceae) me rrënjë të zhvilluara barishtore, me kërcell deri 3 m të lartë, me gjethe të vendosura përreth tij në mënyrë spirale ose afërsisht nazore. Në Europë është sjellë para 500 vjetësh nga kontinenti amerikan. Në Shqipëri dhe Kosovë është i njohur që nga mesi i shek. XVII kur hyri dhe vesi i tymosjes së duhanit. Duhani mbillej në të gjitha zonat e vendit. Përbërësit kryesorë të duhanit janë: karbohidratet, lëndët proteinike, nikotina dhe derivatet e saj, polifenolet, dylli, vajrat eterike, të cilat përcaktojnë vetitë shijore dhe aromatike të tij. Duhani përdoret kryesisht për t’u tymosur në mënyra dhe forma të ndryshme: cigare, puro, duhan për llullë, për t’u dredhur etj., ose për t’u përtpur dhe nuhatur. Si nënprodukt i duhanit është nikotina, e cila shërben si insekticid për luftimin e disa dëmtuesve të kulturave bujqësore. Çdo vit, më 31 maj, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) alarmon rreziqet shëndetësore që shkakton duhani. Epidemia globale e duhanit vret rreth 6 milionë njerëz në vit, nga të cilët më shumë

se 600,000 janë joduhanpirës (pasivë). Pirja e duhanit është faktor i rëndësishëm rreziku për sëmundjet kardiovaskulare, kancerin e mushkërive dhe format e tjera të neoplazmave, deri te ndryshimet gjenetike. Në një studim të kryer nga UNICEF-i (2013-2014), te moshat 15-49-vjeçare, del se në Kosovë 19.3% e femrave dhe 34.3% e meshkujve konsumojnë duhanin. Ndalimi i abuzimit të duhanit në vende dhe institucione publike, marketingu, reklamimi dhe prodhimi janë rregulluar me ligj të veçantë nga Kuvendi i Kosovës. (Drita Salihu-Zajmi)

DUHLA. Fshat në komunën e Suharekës, 7 km në verilindje të qytetit. Shtrihet në shpatet perëndimore të maleve të Carralevës, në të dy anët e rrugës Prizren-Prishtinë, aty ku lidhet rruga për Malishevë. Në këtë vendbanim hasen gjurmë të shumta të një lokaliteti të vjetër (varreza, gurë themelesh etj.). Rol të rëndësishëm në krijimin dhe zhvillimin e vendbanimit ka luajtur rruga e vjetër romake, që ka lidhur bregdetin shqiptar me brendinë e Gadishullit Ballkanik. Lartësia mbidetare e vendbanimit është 640-740 m, sipërfaqja 1,435 hektarë. Mes dy luftërave botërore kishte kolonë serbë. Në vitin 1948 numëronte 564 banorë, kurse në vitin 1991 kishte 1,399 banorë. Në regjistrimin e vitit 2011, të pranishëm në vendbanim ishin 1,688 banorë. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë jeton jashtë Kosovës. Është vendbanim i tipit të shpërndarë në formë të lagjeve. Ka funksionin e bashkësisë lokale. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, pylltari, blegtori etj. Gjatë luftës së fundit, mbi 80% e fshatit u dogj nga policia dhe paramilitarët serbë, ndërsa një numër banorësh u vranë. Pas luftës fshati është rindërtuar në tërësi. Fshati ka shkollën 9-vjeçare, qendër të mjekësisë familjare, njësi të PTT-së etj. (Valbon Bytyçi)

DUJAKA Aziz (1955-). Mësimdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa Fakultetin e Kulturës Fizike dhe studimet pasuniversitare i kreu në Beograd (1992). Në vitin 2005 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sportit në Prishtinë. Ka botuar tekste për edukatën fizike. Ligjeron lëndën e biomekanikës në Fakultetin e Shkencave Sportive në Universitetin e Prishtinës. (Moral Pozhegu)

DUJAKA Esad (1945-). Gazetar. Lindi në Gjakovë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Dy vjet punoi në shkollën fillore të Cërmjanit, ndërsa më 1968 punësohet në revistën e përjavshme “Zëri i rinisë”. Më 1974 punoi si gazetar-redaktor në Televizionin e Prishtinës dhe në gazetën e përditshme “Rilindja”. Disa vjet ishte reporter i lirë, pastaj redaktor i kronikës së Prishtinës, i faqes së humorit, si dhe redaktor përgjegjës i lajmeve. Në vitin 1997 bëhet redaktor përgjegjës në gazetën “Kosova sot”, ku punon deri më 1999. Nga viti 2000 punon në Radiotelevizionin 21, në redaksinë e lajmeve, si producent, organizator dhe redaktor përpunues. Ka botuar librat “Vitet e ‘Rilindjes’” (2013) dhe “Dëjà vu” (2014). (Veli Bytyçi)

DUKA Ferit (1953-). Historian, profesor. Lindi në Bixëlle të Elbasanit. Kreu studimet në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës (1977) dhe në periudhën 1976-1979 punoi në Arkivin Shtetëror të Shqipërisë. Më pas ishte punonjës shkencor në Institutin e Historisë në Tiranë dhe profesor në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Kreu specializime për turkologji dhe osmanistikë në Universitetet e Ankarasë dhe Stambollit, si dhe për demografi historike në Universitetin e Gracit (Austri). Studimet e F.Dukës përfshijnë qytetet shqiptare, ndryshimet në strukturën shoqërore, politike dhe fetare, suazën ligjore dhe institucionale të viseve shqiptare gjatë sundimit osman etj. Nga kjo fushë ka botuar veprat: “Berati në kohën osmane” (2001), “Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare” (2009), si dhe një numër studimesh për rolin e Kosovës në krijimin e shtetit shqiptar, për vilajetin e Kosovës, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për popullsinë hebreje në Kosovë dhe për vise të tjera shqiptare etj. (Frashër Demaj)

DUKAGJINËT. Familje feudale shqiptare. I pari i kësaj familjeje konsiderohet duka Gjini Tanushi (“ducem Ginium Tanuschius”), që në burimet historike përmendet në fund të shek. XIII, përkatësisht më 1281, si kundërshtar dhe i burgosur i pushtetit anzhuin në Arbëri. Emrin familjar Dukagjini për herë të parë e hasim në një dokument raguzan të vitit 1377, për një njeri me disa mbiemra: Nikollë Stefan Tuderoviç Dukagjini

(Nichola Stephani Tuderoiuch Duchaghin). Ky mund të jetë paraardhësi i njërës degë fillestare të Dukagjinëve. Përfaqësuesi i njërës nga degët e kësaj familjeje është edhe Gjergji, që përmendet në vitin 1403, si pronar i dy fshatrave pranë Lezhës (Balldre dhe Kakarriq) dhe si komandant i një trupe ushtarakësh kalorësie dhe këmbësorie. Gjergji ka vdekur para vitit 1409 dhe, sipas Gjon Muzakës, ka pasur tre djem (Gjergjin, Tanushin dhe Nikollën). Dukagjinët kanë pasur si stemë të tyre një shqiponjë të bardhë me një kokë. Në vitin 1387 ata kanë ftuar tregtarët raguzanë të kalonin nëpër trojet e tyre. Kjo dëshmon se nën qeverisjen e Dukagjinëve ishin krahinat përgjatë rrugës së rëndësishme Lezhë-Prizren, duke përfshirë edhe këto dy qytete. Praninë e pushtetit të tyre në Prizren e dëshmon, sipas rrëfimit të Marin Barleci, përmendorja e ngritur në këtë qytet në përkujtim të Nikollë Dukagjinit. Dukagjinët kanë zotëruar për një periudhë kohe, ndonëse me ndërprerje, rrugën që kalonte nga Deja, përpjetë rrjedhjes së Drinit për në Rrafshin e Dukagjinit e më tutje. Ata në këtë kohë mendohet të kenë zotëruar edhe Pejën. Pasi më 1389 Lezhën ia dorëzuan Venedikut, Dukagjinët humbën kontrollin e rrugës Lezhë-Prizren, por jo ndikimin e tyre në këtë rajon.

Përfaqësuesit më të rëndësishëm të familjes Dukagjini në shek. XV ishin vëllezërit Nikollë dhe Pal Dukagjini dhe i biri i këtij të fundit, Lekë Dukagjini. Të dy vëllezërit ishin pjesëmarrës në Kuvendin e Lezhës (2 mars 1444) dhe e përkrahën Skënderbeun në luftëra kundër osmanëve, por edhe në luftën e viteve 1447-1448 kundër Venedikut. Raportet e Dukagjinëve me Skënderbeun nuk ishin të njëtrajtshme. Ata ndonjëherë u afruan me të, por forcimi i pushtetit të tij bëri që ata kohë pas kohe të afroheshim edhe me Venedikun (1456) dhe me Perandorinë Osmane (1457). Paqja në mes Skënderbeut dhe Dukagjinëve u arrit më 1463, me ndërmjetësimin e argjipeshkvit të Durrësit dhe bashkëluftëtarit të Skënderbeut, Pal Engjëllit. Pas vdekjes së Skënderbeut, Lekë Dukagjini u bë figura kryesore e udhëheqjes së luftës kundërosmane. Tradita popullore e lidhte Kanunin e njohur me emrin e Lekës. Shumë anëtarë të tjerë të kësaj familjeje bujare, edhe pse bartën flamurin e luftës kundërosmane në proceset që pasuan, u konvertuan në besimin

islam, duke i ruajtur pronat e tyre dhe duke u përfshirë në hierarkinë ushtarake e qeverisë së Perandorisë Osmane. (Muhamet Mala)

DUKAGJINI Enver (1928-1986). Gjeograf, profesor universitar. Lindi në Prizren, ku e mbaroi shkollën fillore, ndërsa shkollën normale e kreu në Gjakovë, Shkollën e Lartë Pedagogjike (drejtimi histori-gjeografi) në Beograd më 1951. Punoi për shumë vjet në shkollat e mesme në Prizren dhe Gjilan, ndërsa në vitin 1968 zgjidhet profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Studimet universitare i ndoqi në Shkup, ku u diplomua për gjeografi, ndërsa në Universitetin e Beogradit mbaroi studimet pasuniversitare dhe u doktorua po për gjeografi, në vitin 1975. Në këtë vit zgjidhet mësimsdhënës në Seksionin e Gjeografisë të Universitetit të Prishtinës. Botoi disa artikuj dhe shkrime nga fusha e gjeografisë së popullsisë, të vendbanimeve dhe të ndotjes së mjedisit, në të cilët trajtoheshin probleme të ndryshme të qyteteve të rajonit të Dukagjinit. Vepra e tij më e rëndësishme “Vendbanimet urbane të Metohisë (Dukagjinit)” (Gradska naselja Metohije-Dukagjinia), e botuar në vitin 1978. Gjatë viteve ‘50 mbajti disa vjet burg për arsye politike. (Hivzi Islami)

DUKAGJINI Gjuk’ (Sali Gjuka) (1876-1925). Jurist, mësues, nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë. Lindi në Pejë. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmet në Shkup, ndërsa Fakultetin e Drejtësisë e përfundoi në Selanik. Pas mbarimit të studimeve, nisi punën në gjykatën e Pejës. Në vitin 1909, megjithëse ilegalisht, punoi për hapjen e shkollës shqipe në Pejë. Në vitin 1910, me përkrahjen e Bajram Currit e të Hasan Prishtinës, u bë mësuesi i parë i shqipes në Shkollën Normale dhe gjimnazin e Shkupit. Mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme të viteve 1910-1912. Si përfaqësues nga Kosova dhe delegat i Pejës, i Gjakovës, i Plavës e i Gucisë mori pjesë në shpalljen e pavarësisë kombëtare dhe firmosi aktin me siglën “Salih Gjuka”. U zgjodh këshilltar i Pleqësisë (Senatit). Publikoi në gazetat e kohës shkrime për çështjet e shqipes, të arsimit dhe të luftës për pavarësi. Nga 1913 drejtor i arsimit për qarkun e Beratit. Gj. Dukagjini nuk është shkëputur nga ngjarjet politike e shoqërore të kohës. Ishte ndër organizatorët e Kongresit të Lushnjës dhe

përkrahu Lëvizjen e Qershorit 1924. Pas 1924 punoi pak kohë si drejtor i shkollës plotore të Beratit. (Jahja Hundozi)

DUKAGJINI Jahja Beg (1489-1578). Njëri nga poetët më përfaqësues të letërsisë shqiptare të divanit. Është pinjoll i familjes fisnike shqiptare Dukagjini. U mor devshir në moshë të re dhe pas edukimit dhe aftësimit u inkadrua në detashmentin e jeniçerëve, si oficer i këmbësorisë dhe si edukator. U shqua për zotësi dhe kjo i hapi rrugë të gëzojë përkrahje nga dy bashkëkombësit e tij, Ibrahim Pashë Parga, kryeministër, dhe Skender Çelebiu, ministër i financave, të cilët ishin nga njerëzit më të pushtetshëm të periudhës së parë të sulltan Sylejmanit Ligdhënës. Ishte njëri nga poetët më të mëdhenj, më origjinalë dhe më me ndikim të letërsisë osmane të kohës së tij. Përveç divanit, ka lënë edhe pesë poema të mëdha: “Trezori mistik”, “Libri i parimeve”, “Trëndafilishta e dritësuar”, “Jusufi dhe Zylejhaja”, “Mbreti dhe lypësi” dhe veprën “Kontraste të qytetit të Edrenesë”. Elegjia që ai ia kushtoi princit Mustafa në vitin 1553, pas ekzekutimit nga i ati, sulltan Sylejmani, është njëra nga elegjitë më të njohura në letërsinë klasike osmane. Kjo elegji i kushtoi me syrgjynosje, fillimisht në një çiflig të tij në Zvornik të Bosnjës dhe nga andej shkoi në vendlindjen e tij, në Shqipëri, ku i kaloi vitet e fundit të jetës. Në veprat e tij ai e thekson përkatësinë e tij etnike shqiptare, duke vënë në dukje gjithashtu edhe virtytet më të mira të kësaj etnie. (Nehat Krasniqi)

DUKAGJINI Merre Hysein Pasha (?-1624). Kryeministër i Perandorisë Osmane me origjinë shqiptare. Ishte i biri i Bali Beut dhe stërnip i Mehmet Pashë Dukagjinit. Lindi dhe u shkollua në Pejë. Karrierën politike e nisi si sanxhakbeg i sanxhakut të Shkodrës e të Dukagjinit, me seli në Pejë. Më vonë arriti të zinte poste të larta në administratën osmane. Në kohën e sulltan Mehmetit III (1595-1603) ishte komandant i ushtrisë osmane në Hungari. Pastaj e gjejmë si oficer dhe drejtues i kavalerisë së pallatit të sulltanit. Në vitet 1620-1622 ishte vali i Egjiptit, por kulmin e karrierës e arriti me postin më të lartë në shtet, vezir i parë apo sadriazem (kryeministër) i Perandorisë Osmane. Si sadriazem u quajt Merre Hysen pasha, apo edhe Arnavud Hysein. Mbajti dy herë shkurtazi postin e sadriazemit (13

qershor - 8 korrik 1622 dhe 5 shkurt - 30 gusht 1623). Sa e mbajti postin e sadriazemit, thuhet se komunikonte vetëm shqip me personelin e Portës së Lartë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin shqiptarë. Se ishte i lidhur me vendlindjen e tij, Pejën, e tregon fakti se ndërtoi në Pejë xhaminë me emrin e tij, ndërkaq në pronën e vet, si vakëf, ndërtoi një sërë dyqanesh, të cilët ndodhen edhe sot në rrugicën nga Çarshi Xhamia për në rrugën “Ramiz Sadiku”, si dhe një mulli në fshatin Zllakuqan. Njëmbëdhjetë muaj pas shkarkimit nga posti i sadriazemit, Merre Hysein Pasha u ekzekutua me urdhrin e sulltan Muratit IV, sepse autoriteti i tij i madh, siç njoftojnë burimet osmane, e kërcënonte edhe vetë sulltanin. (Gazmend Rizaj)

DUKAS (rreth 1400-1470). Historian dhe diplomat bizantin. Pas rënies së Konstandinopojës nën sundimin osman (1453), shërbeu në misionet diplomatike të princërve gjenovas (Dorino dhe Domenico Gateluzzi), që zotëronin ishullin Lesbos. I përket grupit të historianëve bizantinë, që u morën me histori pas rënies së Perandorisë Bizantine. Është autor i veprës “Historia turko-bizantine”. Vepra u përkthye edhe në italishten venete, nga një përkthyes anonim, i cili kishte shtuar ndonjë pjesë që nuk janë në versionin grek. Në veprë flitet për historinë e përgjithshme, që nga Adami deri te Johan Paleologu (1341), sidomos për historinë mbi 100-vjeçare të Perandorisë Bizantine (1341-1461). Dukasi flet edhe për pushtimin osman të trevave ballkanike dhe në këtë kontekst ofron njoftime për Betejën e Kosovës më 1389, si dhe atë të vitit 1448. Bën dallimin e qartë midis serbëve dhe tribalëve. Këta të fundit i trajton në kuadër të “etnosit të gjerë të Ballkanit”. (Ramiz Abdyl)

DULA Abas (1942-2013). Gazetar i sportit. Lindi në Gjakovë. Ishte njëri ndër pionierët e gazetarisë sportive të Kosovës. Kaloi shumë vjet në redaksinë e sportit të gazetës “Rilindja”, ku raportoi nga shumë ngjarje sportive vendore dhe ndërkombëtare. Ndoqi me shumë pasion zhvillimin e hendbollit në Kosovë, veçmas garat e klubeve të njohur të Kosovës: “Borcin” e Ferizajt dhe “Trepçën” e Mitrovicës, “Vëllaznimit” e Gjakovës dhe “Bozhurin” e Gjilanit, “Prishtinën” dhe “Kosovën” e Vushtrrisë. A. Dula ishte kryetar i Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës deri në mbarim

të luftës. Pas mbylljes së gazetës “Rilindja”, A. Dula e pushoi angazhimin profesional në fushën e gazetarisë. (Ejup Llumnica)

DULA Jashar (1938-2013). Mjek, stomatolog, kirurg maksilofacial, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prizren, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1966). Pas diplomimit punësohet si stomatolog në Prizren. Më 1972 mbaron specializimin nga lënda kirurgjia maksilofaciale në Akademinë Mjekësore Ushtarake në Beograd. Pas specializimit kthehet në Gjakovë dhe hap për herë të parë në Kosovë shërbimin nga kirurgjia maksilofaciale. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, në vitin 1976 zgjidhet asistent për lëndën bazat e kirurgjisë maksilofaciale. Më 1984 mbron tezën e doktoratës dhe më pas zgjidhet docent, profesor inordinar dhe më 1995 profesor ordinar i lëndës kirurgjia maksilofaciale në degën e stomatologjisë të Fakultetit e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Fatmir Dragidella)

DULA Xhevdet (1954-). Piktur. Lindi në Hereç të Gjakovës. Shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit i kreu në Pejë. U diplomua në Akademinë e Arteve (drejtimin e pikturës) në Prishtinë (1978). Një kohë punoi në shkollën e mesme në Bujanoc (1979-1987), më vonë në Entin Pedagogjik të Vranjës. Ishte drejtor i Qendrës arsimore “Sezai Surroi” në Bujanoc (1993-2005). Si anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Serbisë dhe i UNESKO-s mori pjesë në ekspozita kolektive në rajon dhe më gjerë. Hapi disa ekspozita personale në Pula (1978, 1979), në Pozharevc (1981), në Bujanoc (1983), në Prishtinë (1985), në Leskovc (1986), në Beograd (1986), në Toronto, Kanada (1996) dhe në Nish (1997). Piktura e tij është e pasur me trajta të zgjedhura dhe të imagjinuara, shprehje impulsive dhe ekspresive, tingulli ngjyre me nuancime zjarri dhe deti. Jeton në Bujanoc. (Rexhep Goçi)

DULLËT. Shtresë e skllëvërve në shoqërinë dardane. Kjo kategori shoqërore shërbente kryesisht për punët bujqësore dhe në minierat

e shumta të Dardanisë. Pos dullëve dhe robërve të luftës, si shtresa më të ulëta, në shoqërinë dardane bënin pjesë dhe aristokracia skllavopronare, në krye me mbretin, bashkë me priftërinjtë dhe shtresën e lartë ushtarake, pastaj shtresa e xehetarëve, zejtarëve e tregtarëve dhe fshatarësia e lirë. Si shtresë e varur, dullët përmenden te autori antik Ateneu (douloi: Athenaeus, Deipnosophiste VI 103, 277d). (Arsim Havolli)

DUMNICA E POSHTME. Fshat në juglindje të Vushtrrisë, rreth 8 km nga qendra komunale. Shtrihet në kodrinat afër malit të Kopaonikut dhe është vendbanim i tipit të shpërndarë, i ndarë në disa lagje. Në jug të këtij vendbanimi, rreth 3 km larg, janë gjetur gjurmë të shumta arkeologjike (tulla, tjegulla, mure nga guri), që dëshmojnë për lashtësinë e tij. Në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455 ishte i regjistruar si vendbanim i braktisur-merza, në kuadrin e Nahijes së Vushtrrisë. Ndërsa, në regjistrin kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566-74 ishte i regjistruar si vendbanim me emrin Dolina Dubnica me 12 shtëpi. Sipas një harte etnografike të fund shek. XIX, ky vendbanim kishte 80 shtëpi shqiptare. Në vitin 1999 fshati kishte 213 shtëpi me rreth 1,800 banorë. (Skender Halimi)

DUMOSHI Ismail (1939-1988). Veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, Shkollën Normale dhe më pas Fakultetin Filozofik (gjuhë dhe



ISMAIL DUMOSHI

letërsinë shqipe) i kreu në Prishtinë (1965). Punoi si mësues në Ferizaj dhe në Prishtinë dhe më pas drejtor i Qendrës Shkollore "Nikolla Tesla" në Obiliq. Më 1964 u bë anëtar i Lëvizjes

Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968. Falë rolit të tij në organizimin e demonstratave "Eminenca e kaltër", siç njihet nga bashkëveprimtarët e asaj kohe, shumë veprimtarë të "Çetës Bajo dhe Çerçiz Topulli", personalisht ose me anë të të besueshmëve, para e pas demonstratave, informuan përfaqësuesit diplomatikë të Shqipërisë e të disa shteteve të tjera në Beograd, Sofje, Bukuresht, Budapest,

Vjenë, Stamboll, Ankara e Selanik për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare. Gjatë kësaj kohe shtëpia e familjes së I. Dumoshit ishte bërë strehë e shumë studentëve, të cilët vinin për studime në Prishtinë. Në atë shtëpi ishin bërë planet e lëvizjes ilegale dhe planet për organizimin e demonstratave. Për shkak të angazhimeve kombëtare, më 1972, I. Dumoshi u shkarkua nga detyra e drejtorit dhe iu ndalua puna në arsim. Përkrahu dhe ndihmoi demonstratat e vitit 1981. Për merita të jashtëzakonshme për çështjen kombëtare presidentja e Republikës së Kosovës e dekoroi me urdhrin "Hero i Kosovës". (Izber Hoti)

DUMOSHI Osman (1946-2003). Veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, të mesmen dhe Fakultetin Teknik, degën e Makinerisë i kreu në Prishtinë. Më 1964 u anëtarësua në Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Që herët Shtëpia e Sadushes, nënës së Ismailit dhe Osmanit, u shndërrua jo vetëm në një konvikt për strehimin e shokëve veprimtarë të njohur dhe të panjohur, por edhe në një pikëtakim të veprimtarëve dhe intelektualëve të kohës. Ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968. Për pjesëmarrje dhe organizim në këto demonstrata Osmani u dënua me 5 vjet burg të rëndë, kurse në procesin gjyqësor më 1975 kundër Adem Demaqit u dënua edhe me 7 vjet të tjera burg. Osmani ishte aktiv dhe kontribues edhe në demonstratat e v. 1981, prandaj familja Dumoshi do të stigmatizohej e ndiqej gjatë gjithë kohës nga pushteti i atëhershëm. Në jetën politike ishte aktiv edhe pas vitit 2000, duke kontribuar në formimin dhe forcimin e Republikës së Kosovës nëpërmjet organizmave partiakë dhe shtetërorë. Për merita kombëtare Presidencia e Kosovës e dekoroi me medaljen "Urdhri i Lirisë". Vdiq në Prishtinë. (Izber Hoti)

DUMPINGU. Dukuria e shitjes së produktit në tregun e jashtëm nën vlerën e tij reale. Në këto raste çmimi në tregun e jashtëm i produktit të caktuar është më i ulët se ai në tregun e origjinës (në tregun e brendshëm) dhe ndodh që produkti shitet nën koston reale. Në esencë, kjo dukuri konsiderohet si praktikë normale në transaksionet ndërkombëtare dhe nga aspekti ekonomik përgjithësisht prodhon efekte pozitive të hyrjes në një treg të ri. Mirëpo, në raste të caktuara një zhvillim i tillë

është i dëmshëm për konkurrencën. Në raste të tilla, qeveritë nacionale, kur vërtetohet dëmi që dumpingu i produkteve u shkakton prodhuesve vendorë, aplikojnë masa antidumping. Procesi i vërtetimit të dëmit nga dumpingu është shumë kompleks, i gjatë në kohë dhe kërkon mekanizma të zhvilluar institucionalë për t'i hulumtuar rastet. Në rastin e Kosovës, fusha e veprimit në kontekst të dumpingut dhe masave korresponduese antidumping është përcaktuar në ligjin përkatës për masat antidumping dhe për masat kundërbalancuese, i miratuar në vitin 2014. Deri më tani janë inicuar tri raste, duke u bazuar në legjislacionin në fjalë: rasti i mishit të pulës brojler, i blloqeve për ndërtimtari dhe i prodhimeve të argjilës. (Petrit Gashi)

DURA Avdyll (1893-1949). Veprimtar i çështjes kombëtare. Emri i tij i plotë është Avdyll Zejnulla Zenuni. Lindi në Duraj të Kaçanikut. Më 1926 u zgjodh kryetar i komunës së Sllatinës së Lepencit, pozitë që e mbajti deri më 1937. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u angazhua kundër pushtetit fashist bullgar. U zgjodh komandant i vullnetarëve të Kaçanikut (1941-1944). Në fillim të vitit 1945, si i mobilizuar, u përfshi në Brigadën VII të Kosovës, me të cilën u dërgua të luftonte në Vojvodinë, në Frontin e Sremit. Pas kthimit arrestohet nga UDB-ja dhe dërgohet në burgun e Ferizajt (korrik 1945). Në nëntor të atij viti u arratis nga burgu, por pas një viti u arrestua sërish, së bashku me gjithë familjen e tij prej 25 anëtarësh (maj, 1946), që u mbajtën në burg gati për tri vjet. Më 28 qershor 1949 u vra nga forcat policore në një përpjekje të përroska e Bajincës. Trupi i tij u ekspozua më pas në qendër të qytetit të Ferizajt. (Skënder Lutfiu).

DURAKOVIQ (Duraković) Esad (1948-). Filolog, profesor, akademik, përkthyes. Lindi në Glavica, Bugojno (Bosnjë e Hercegovinë). Shkollimin fillor dhe të mesëm i ndoqi në Sarajevë. U diplomua më 1972 për gjuhë dhe letërsi arabe në Universitetin e Beogradit, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit. Profesor i gjuhës dhe i letërsisë arabe dhe orientalist i njohur në Prishtinë deri më 1990. Pas viteve '90 profesor i letërsisë arabe në Sarajevë. Anëtar korrespondent i Akademisë Arabe të Shkencave në Damask e Kajro, anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnjës e Hercegovinës. Puna e tij shkencore

është përqendruar kryesisht në gjuhë e letërsi arabe dhe orientologji. Përkthimi i tij i "Një mijë e një net" në gjuhën boshnjake në vitin 1999 është shpallur ngjarje kulturore e vitit. (Jahja Hundozi)

DURAKU Emin (1918-1942). Pjesëtar i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, Hero i Popullit. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në Gjakovë. Më 1932 emigroi në



EMIN DURAKU

Shqipëri, u vendos në Tiranë dhe pastaj në Shkodër. Për shkak të aktivitetit politik përjashtohet nga gjimnazi i Tiranës (1935) dhe vijon mësimet në Shkodër. Si veprimtar komunist më 1938 gjykata e Tiranës e dënon me tre vjet burg. Në prill të vitit 1939 arratiset nga burgu dhe vazhdon aktivitetin ilegal në Shkodër. Në korrik të vitit 1939 kthehet në Gjakovë, ku vë kontaktet e para me komunistët e Kosovës. Kthehet sërish në Shkodër dhe më 28 nëntor 1939 organizon demonstratë antifashiste. Pas arrestimit dërgohet në ishullin Vetoteno në Itali. Në vjeshtën e vitit 1941, pas një amnistie, kthehet në Tiranë. Vë kontakt me veprimtarët komunistë dhe dërgohet në Gjakovë, me detyrë që të përhapë idetë komuniste. Në këshillimin e shkurtit të vitit 1942 të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) për Kosovë dhe Metohi (Dukagjin) mbahti referatin kryesor. Pasi u kooptua në Byronë e Komitetit Krahinor të PKJ-së, më 28 nëntor 1942 në fshatin Grackë, afër Lipjanit, u vendos në një shtëpi koloni, ku u rrethua dhe pas një rezistence plagoset rëndë. Vdes më 5 dhjetor në spitalin e Prizrenit. (Hakif Bajrami)

DURAKU Nebil (1834-1989). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Brojë të Drenicës. Arsimin fillor e kreu në Turiçec. Shkollën e mesme tregtare-financiare e përfundoi në Pejë. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe më pas studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësues në Prekaz, Runik dhe Turiçec. Nga viti 1957 u bë gazetar dhe reporter i gazetës "Rilindja", më pas redaktor i "Gazetës së delegatëve" të Kuvendit të Kosovës (1975-1977) dhe reporter-redaktor i Televizionit të Prishtinës (1977-1989). Ishte

edhe bashkëpunëtor i revistave "VUS" (Vjesnik u sredu) të Zagrebit, "Delo" të Lubjanës etj. Me shkrimet për fëmijë dhe të rritur paraqitet që nga viti 1952. Shkroi tregime, novela dhe romane. Botoi përmbledhjet me tregime "Topi i larmë" (1965) dhe "Kobi", (1983), si dhe romanet "Murgësja" (1966), "Shtrojera" (1969), "Drenusha" (1980), "Dhengrënësit" (1980), "Murana" (1986), "Egjra" (1989). Për Radio Prishtinën realizoi edhe radiodramat "Tregtari i kafshatave të dreqit" dhe "Kah fryn era", ndërsa për Televizionin e Prishtinës dramën televizive "Kopshti i pleqërisë". Në skenë u shfaq drama e tij "Maska e çjerrë". Më 1980 u botua leksikoni "Shkrimtarët e Kosovës 1943-'83". Vepra e plotë e N. Durakut u botua në vitin 1998. (Isak Shema)

DURANTI Argjipeshkëv Daniel (1633-1713). Prift françeskan, argjipeshkëv i Argjipeshkvisë Shkup-Prizren (1690-1702). Lindi në Arezzo (Aretin) afër Firencës, në Itali. U shugurua prift françeskan në vitin 1664. Në krye të argjipeshkvisë u emërua në vitin 1690 dhe trashëgoi Pjetër Bogdanin. Para kësaj ishte misionar në Kajro të Egjiptit, pastaj lektor për gjuhën arabe në Romë, prokurator kryesues i misioneve dhe administrator apostolik në Izmir, Turqi. Për shkak të kushteve të rënda që mbretëronin aso kohe në Perandorinë Osmane, nuk arriti në dioqezën e tij, por vetëm deri në Kotorr. Për shkak të këtyre rrethanave, më 1702 dha dorëheqje nga selia e Shkupit. Në krye të kësaj selie, me vendim të papës Klementit XI, erdhi Pjetër Karagiqi nga Novobërda. (Gjon Berisha)

DURHAM Edit (Mary Edith) (1863-1944). Antropologe, shkrimtare, publiciste dhe udhëpërshkruese. Lindi në Hanover Skuer në Londër. Studioi në Kolegjin Bedford (1878-



EDIT DURHAM

1882), pastaj në "Royal Academy Schools". Babai i saj, Artur Eduard Durham, ishte mjek, kirurg i njohur në Londër. E. Durham u bë e njohur me udhëtimet e saj në disa vende të Ballkanit. Më 1900 nis udhëtimet për herë të parë, për shkaqe shëndetësore. Në udhëtimet e saj u përqendrua veçanërisht në Shqipëri,

ku u njoh me kulturën, historinë, traditat, zakonet e deri te kërkesat politike të shqiptarëve. Si njohëse e mirë e rrethanave ballkanike, ajo i kishte informuar zyrtarët e lartë britanikë për ngjarjet e rëndësishme në Shqipëri, sidomos për masakrat e ushtrive të Aleancës Ballkanike mbi popullsinë civile shqiptare gjatë viteve 1912-1913. Ndërkaq, kontributet e saj u botuan në revista e periodikë të ndryshëm në Britani. Për shkak të interesimeve të saj dhe të rezultateve në fushën e antropologjisë, ajo u bë një anëtare e rëndësishme e Institutit Antropologjik Mbretëror. E. Durham shkroi shtatë libra mbi çështjet e Ballkanit, ndër të cilat: "Shqipëria e Epërme" (1909); "Lufta për Shkodrën" (1914); "Njëzet vjet ngatërresa ballkanike" (1920); "Mbi origjinën e disa fiseve, kanune dhe zakone të vendeve të Ballkanit" etj. Për shkak të afërsisë së krijuar me malësorët shqiptarë dhe respektit që krijuan për të, u quajt "Mbretëresha e Malësisë". Në shenjë revolte për dhunën dhe masakrat që ushtria serbe dhe malazeze bënë ndaj shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore, ajo ia ktheu dekoratat mbretit Nikolla i Malit të Zi dhe mbretit Petar të Serbisë. Gjatë kohës së qëndrimit në rajonin e Ballkanit, E. Durham mblodhi shumë dokumente dhe materiale të ndryshme që lidheshin me kulturën, traditën, antropologjinë dhe aspekte të tjera të rëndësishme nga jeta e përditshme në Shqipëri. Dokumentet dhe materialet e saj të mblledhura gjatë kohës së udhëtimeve në Ballkan mbahen nga Instituti Antropologjik Mbretëror në Londër. Ditarët e saj gjenden në Muzeun Bankfield, Halifax, së bashku me koleksionet e saj të veshjes ballkanike dhe të stolive, të cilat ia dhuroi muzeut në vitin 1935. Veprat e Edit Durham-it për Shqipërinë dhe shqiptarët kanë vlerë kulturore, etnografike dhe historike. (Jusuf Bajraktari)

DURIQI Arian (1978-). Gazetar, ish-futbollist. Lindi në Prishtinë. Shkollimin e kreu në Lipjan, ndërsa studioi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi si gazetar në gazetën sportive "Sport plus", ndërsa pas lufte në gazetën javore "Kosova sport". Më 2004 angazhohet gazetar në të përditshmen "Koha ditore". A. Duriqi shquhet edhe si sportist. Ka bërë karrierën e futbollit në Kosovë dhe jashtë saj. Në Kosovë ka luajtur për disa skuadra ("Ulpiana", "2 Korriku", "Arbëria" etj.), ndërsa jashtë është paraqitur me skuadrën

e “B 1909” në “Odense” të Danimarkës. (Besim Kajtazi)

DURMISHI Eshref (1981-). Aktor dhe producent. Lindi në Rakincë të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Gjakovë dhe në Gjermani. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Filloi krijimtarinë artistike me shfaqjen “Galani” (2003) në Teatrin “Dodona”, në Prishtinë. Më pas, në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet: “Beselam, pse më flijojnë” (2010), “Nata e dymbëdhjetë” (2011), “Vdekja e një komisionieri” (2014) dhe në Teatrin Oda në shfaqjet “Burrneshat” (2012), “Muret e padukshme” (2013) etj. Në Teatrin e Mitrovicës luajti në shfaqjet “Vetmi në Perëndim” (2011), “Langonjtë” (2012), “Identiteti i dyfishtë” (2013). Në rolin kryesor luajti në filmin greko-gjerman “Eduart” (2006), si dhe në rol dytësor në filmin shqiptar “Ada” (2013) dhe në një rol episodik në filmin kosovar-gjerman “Babai” (2015). Luajti edhe në shumë filma të shkurtër dhe në disa seriale televizive. Është aktor dhe bashkëproducent i filmit të shkurtër “Shok”, i cili më 2016 u nominua për çmimin Oscar. (Doruntina Basha)

DURMISHI Luan (1982-). Tenor. Kreu shkollën e ulët dhe të mesme të muzikës në Prishtinë, u diplomua në drejtimin për solokëndim në Fakultetin e Arteve (prof. Merita Juniku). Në periudhën 2013-2014, iu bashkëngjiti Institutit “Voce D’oro” me bursë 6-mujore për studim vokal dhe repertor në Nju-Jork (SHBA) me prof. Dorothy Stone. Ka interpretuar arie dhe role veprash nga kompozitorë të njohur të huaj dhe shqiptarë, në manifestime e festivale të ndryshme: në SHBA, Francë, Austri, Zvicër, Kroaci, Gjermani, Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Shqipëri, Maqedoni. Ishte anëtar i Ansambllit vokal “Okteti +”, themelues i Orkestrës kamerale “Rexho Mulliqi” (2011). Është anëtar i Korit të Filarmonisë së Kosovës. (Besa Luzha)

DURMISHI Skënder (1956-). Gazetar, diplomat. Lindi në Shajkoc të Podujevës. Shkollimin e mesëm e mbaroi në Podujevë, ndërsa diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Studimet e magjistraturës nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare i kreu po

në Prishtinë, ndërsa studimet e doktoraturës i përfundoi në Universitetin e Shkupit. Punën e gazetarit e nisi në gazetën e studentëve “Bota e re”, pastaj vazhdoi si gazetar, redaktor dhe moderator në Televizionin e Prishtinës (TVP). Pas mbylljes së TVP-së punoi për një kohë në Tiranë, si pjesë e ekipit të gazetarëve dhe redaktorëve për Kosovën. Pas luftës punoi gazetar, redaktor dhe moderator i emisioneve informative dhe dokumentare në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK). Për një mandat ishte zëvendës i ambasadorit të Republikës së Kosovës në Bruksel, pastaj i ngarkuar me punë, ndërsa për tri vjet ishte shef i misionit në Ambasadën e Kosovës në Maqedoni. Po në këtë detyrë ishte edhe në Australi. Nga prilli 2016 është ambasador i Kosovës në Mal të Zi. (Artan Krasniqi)

DUSHANI Stefan (1331-1355). Mbret dhe perandor i Serbisë. Pasi mori pushtetin në Rashë (Serbi), shtypi kryengritjen që shpërtheu në Zetë (Mal të Zi) dhe në trevën e Shkodrës, nën udhëheqjen e fisnikut shqiptar, Dhimitër Suma (1332). Duke shfrytëzuar trazirat në Bizant, më 1334 Dushani depërtoi në jug, në Maqedoni, dhe pushtoi Prilepin dhe Strumicën. Po këtë vit pushtoi qytetin e Ohrit. Më pas, për një kohë, ai bëri paqe me Bizantin, por pastaj sërish ndërmoi ekspedita, duke pushtuar Vodenin, Lerinin dhe Melnikun (1342-1343) në Maqedoninë Jugore, si dhe Kosturin (1343), Krujë (1343), Beratin e Kaninën (1346) dhe Vlorën (1347). Më 1348 pushtoi Epirin dhe Thesalinë. Rrjedhimisht, Stefan Dushani, që u shpall perandor në Shkup dhe nga viti 1346 filloi të titullohej “perandor i Romanisë, i Skllavonisë dhe i Arbërisë”, krijoi Perandorinë Serbe që shtrihej nga Danubi në veri deri në Gjirin e Korintit në jug. Prizreni dhe Shkupi u bënë seli të saj. Ky pushtim u shoqërua me vendosjen e kolonëve serbë në Dardani. Dushani themeloi Patrikanën Serbe me qendër në Pejë. Asaj dhe manastireve të serbizuara në Dardani u fali një numër të madh fshatrash. Në viset e pushtuara vendosi qeveritarë serbë. Për të përforcuar pushtetin perandorak, u hartua “Kodi i Dushanit” (1349, 1354), i cili ishte diskriminues për shqiptarët. Pas vdekjes së Dushanit, Perandoria Serbe u shpërbë. Vendin e saj në pjesën më të madhe të tokave shqiptare e zunë principatat e pavarura të fisnikëve vendas. Janina, Vlora, Skupi, Pollogu dhe Dardania mbetën për një kohë nën sundimin e feudalëve sllavë. (Qerim Dalipi)

DUSHI Afrim (1945-). Inxhinier i teknologjisë organike. Lindi në Gjakovë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prizren, Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë, ndërsa studimet në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Sarajevës (1972). U punësua në Industrinë e Gomës “Ballkan” në Suharekë, ku kreu detyrën e udhëheqësit të kontrollit teknik, të drejtorit të zhvillimit, të investimeve dhe të marketingut. Ishte i angazhuar edhe në punë kërkimore-shkencore. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, që janë botuar në revista dhe përmbledhje studimesh. Kreu disa specializime jashtë vendit dhe ishte pjesëmarrës në një sërë tubimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. Në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë kaloi nëpër proceset e zgjedhjeve në titujt përkatës universitarë. Është autor i disa teksteve për shkollat e mesme. (Shefqet Rashani)

DUSHI Albert (1934-1991). Gazetar. Lindi në Bilisht të Korçës. Shkollimin fillor e nisi në Prizren dhe e vazhdoi në Gjakovë. Një kohë punoi në Minierën e Devës (Gjakovë) dhe pastaj mësues në Zhegër të Gjilanit. Një vit ndoqi studion e dramës në Fakultetin e Arteve në Beograd dhe pastaj u angazhua si aktor në Teatrin e Mitrovicës dhe në Teatrin Krahinor në Prishtinë. Filloi të shkruante në gazetën “Rilindja” për ngjarje sportive. Kur “Rilindja” filloi të dalë e përditshme (1958), A. Dushi u bë gazetar i saj. Në vitet ’70 punoi korrespondent i agjencisë jugosllave të lajmeve “Tanjug” dhe më pas i gazetës “Komunist” në Beograd. Ndërkohë kreu studimet për sociologji në Sarajevë dhe emërohet drejtor i shtëpisë filmike jugosllave “Filmske novosti”. Është autor i librit publicistik “Kosova në shifra e në fakte”, botuar në gjuhën shqipe, serbo-kroate dhe disa në gjuhë të huaja. (Zenun Çelaj)

DUSHI Arbnora (1972-). Studiuuese e folklorit. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, shkollimin e mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet për letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (1995). Po në këtë fakultet i kreu edhe studimet pasuniversitare dhe e mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (2009). Ka realizuar edhe një sërë specializimesh nga fusha e folkloristikës, në institute e universitete publike në SHBA, në Finlandë, në Austri, në Spanjë e



ARBнора DUSHI

në Itali dhe qëndroi për studime pasdoktorale në katedrën e folkloristikës krahasimtare në Universitetin e Turkut (Finlandë) gjatë vitit shkollor 2011/12. Nga viti 1997 punon në degën e folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku ka arritur gradën e këshilltares shkencore. Është autore e monografive “Elemente të epikës gojore shqiptare në prozën e Ismail Kadarese”, „Homo Narrans - Rrëfimi personal gojor”, përmbledhjen me studime “Folklori përtej kufijve”, si dhe i përmbledhjes me studime të përkthyer: “Folkloristikë, koncepte moderne”. Është autore e punimit për folklorin shqiptar në “Enciklopedinë e folklorit botëror” (Greenwood House, SHBA, 2006). (Vlorë Fetaj-Berisha)

DUSHI Avni (1940-). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë në Universitetin e Zagrebit (1968). Fillimisht punësohet në minierën e “Trepçës” në Stantërg (1968) si inxhinier praktikant. Kreu një varg detyrash me rëndësi: inxhinier reparti, shef i transportit të xeherorit, drejtues i një pjese të minierës, inxhinier në sektorin e zhvillimit (1974-1977), drejtor i Organizatës Bazë të Punës së Bashkuar “Hulumtimi dhe zhvillimi”. Nga viti 1981 e deri në largimin me dhunë nga puna (1990) është drejtues i Entit për gjeologji dhe xehetari në Institutin për plumb dhe zink në Zveçan. A. Dushi ka qenë i angazhuar edhe në procesin mësimor: fillimisht në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë (1968-1975) dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë (1976-1982), si asistent dhe më vonë si ligjërues i autorizuar për lëndën sistemet e shfrytëzimit të vendburimeve në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm. (Shyqeri Kelmendi)

DUSHI Hajdar (1916-1944). Pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Hero i Popullit. Lindi në Gjakovë. Mësimet e para i mori në vendlindje, gjimnazin e kreu në Shkodër, ku vuri kontaktet e para me grupet komuniste shqiptare. Me formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH), u pranua



HAJDAR DUSHI

si anëtar i saj. Në vitin 1941 u emërua sekretar organizativ i Komitetit të PKSH-së për Qarkun e Durrësit. Ndërkohë u dërgua në Berat si i deleguar i Komitetit Qendror të PKSH-së, me detyrë për të ndihmuar në ngritjen dhe avancimin e strukturave të Partisë. U arrestua dhe u mbajt në burg rreth 9 muaj. Pasi u arratis nga burgu i Tiranës, iu bashkua çetës partizane të Çermenikës. Në vitin 1943 u caktua zëvendëskomisar i batalionit partizan të Shkodrës “Perlat Rexhepi”. Me direktivë të PKSH-së u dërgua në Kosovë, për të ndihmuar komunistët në ngritjen e strukturave ushtarake. Ishte pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit dhe njëri nga hartuesit e Rezolutës së Konferencës. U vra në luftime afër Kalasë së Dodës në zonën e Dibrës më 22 shtator 1944 nga forcat antikomuniste. (Frashër Demaj)

DUSHI Haki (1930-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu një pjesë të shkollimit bazë, që më pas e vazhdoi edhe në Pejë, ndërsa studimet e larta për ekonomi i përfundoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Beogradit (1959). Nga vitit 1964 punoi mësimdhënës në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë, ku mbajti leksione në lëndën bazat e kontabilitetit, ndërsa nga viti 1969 të njëjtën lëndë e ligjëroi edhe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Tezën e magjistraturës e mbrojti në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa në vitin 1978 mbrojti tezën e disertacionit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, po nga fusha e kontabilitetit. Ka qenë dekan i Fakultetit Ekonomik për dy mandate, shef i katedrës për kontabilitet, matematikë dhe statistikë dhe ka mbajtur ligjërata edhe në disa universitete dhe kolegje private. Ka botuar punime shkencore në revista të ndryshme profesionale. (Nail Reshidi)

DUSHI Masar (1956-). Arkitekt, ligjërues. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje. U diplomua në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Sarajevës (1979). Pas diplomimit punoi në ndërmarrjen

ndërtimore “Dukagjini” dhe në Kuvendin Komunal të Gjakovës, në Entin për Urbanizëm dhe Projektme, ku për 6 vjet ka qenë drejtor. U angazhua si bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (1979-1993) për lëndën konstruktionet arkitektonike. Në periudhën e pasluftës u angazhua në programet e rindërtimit dhe të strehimit emergjent të OJQ-së amerikane “IRC” në Prishtinë dhe në Tiranë. Nga projektet e realizuara u veçua rikonstruktimi i kompleksit Çarshia e Madhe në Gjakovë. U mor edhe me projektimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të objekteve kapitale. Ka realizuar për herë të parë në Kosovë një objekt të ndërtimit të lartë, i ngritur mbi pilotë (pilonë) të “mbjellë” në terren të pjerrët. (Dervish Qerreti).

DUSHI Minir (1929-). Inxhinier i xehetarisë, profesor universiteti, veteran i arsimit, akademik. Lindi në Gjakovë. Ishte pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.



MINIR DUSHI

Shkollën e mesme teknike e kreu në Nish (1950), Fakultetin e Xehetarisë në Universitetin e Beogradit (1958) dhe po aty e mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1965). Pas diplomimit punoi si inxhinier në minierën e Stantërgut dhe më pas punoi dhe ishte udhëheqës në një sërë institucioneve arsimore-shkencore të Kosovës: në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë (1961), në Institutin e plumb-zinkut të kombinatit “Trepça” (1966) dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë (1974), pastaj profesor ordinar i Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1974), dekan i Fakultetit të Xehetarisë dhe të Metalurgjisë (1975-1979), prorektor i UP-së (1970-1979), rektor i UP-së (1981-1983) dhe anëtar i Kryesisë së KSA të Kosovës (1986-1989). Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) u zgjodh nga themelimi i saj (1975), kurse në vitin 1978 u bë anëtar i rregullt i ASHAK-ut. Vepra shkencore e M. Dushit përbëhet nga një numër i madh punimesh shkencore-profesionale të botuara në shtypin shkencor, pastaj nga një sërë studimesh, artikujsh shkencorë, recensionesh etj. nga fusha e

gjeologjisë, e minierave dhe e industrisë së përpunimit të mineraleve. Është autor i disa teksteve universitare: "Makinat minerare" (1975), "Makinat minerare transportuese" (1996), "Sistemet ciklike të transportit" (1999) etj., pastaj i një sërë monografish shkencore: "Trepça" (2002), "Universiteti i Kosovës" (2004), "Veprimtaria shkencore në 'Trepçë'" (2006), "Pasuritë minerale të Kosovës" I dhe II (2009), "Qymyri i Republikës së Kosovës" (2012), "Boksitet e Dukagjinit" (2015) etj. Në Institutin e "Trepçës" inicioi botimin e revistës së parë nga lëmi i shkencave teknike "Plumb-zinku" (1968). Që nga viti 1980 është kryeredaktor i revistës "Kërkime" të ASHAK-ut. Në jubileun e 25-vjetorit të themelimit, senati i Universitetit të Prishtinës i dha titullin "Profesor emeritus", ndërsa këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Xehetar-Metalurgjik i UP-së e shpalli "Dekan nderi" (1996). Për rezultate në punë dhe për organizimin e veprimtarisë shkencore dhe arsimore dhe për përparimin e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë, M. Dushi u nderua me shumë mirënjohje, çmime dhe dekorata. Në vitin 2011 u shpall "Qytetar nderi" i Gjakovës, ndërsa në vitin 2014 "Qytetar nderi" i Mitrovicës. (Nexhat Daci)

DUSHI Petrit (1930-2015). Gazetar, spiker. Lindi në Bilisht të Korçës. Shkollën fillore e mbaroi në Prishtinë, të mesmen në Gjakovë dhe Prishtinë, Fakultetin e Drejtësisë në Prishtinë. Në vitet 1951-1969 punoi në Radio Prishtinë, si spiker dhe moderator, drejtor i shërbimit të programacionit, themelues dhe drejtor i produksionit muzikor. Nga viti 1969 e deri më 1971 ishte sekretar dhe producent i "Kosovafilmit". Në vitin 1971 u kthye sërish në Radiotelevizionin e Prishtinës, si këshilltar dhe drejtor i produksionit, pastaj redaktor përgjegjës i programit të dytë të Radio Prishtinës. Ishte kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i TVP-së, deri në vitin 1981 dhe më pas u caktua të themelojë shërbimin e hulumtimit të programit dhe të auditorit. Një kohë të shkurtër udhëhoqi shërbimin e parapagimit dhe të reklamave (marketingun), prej nga doli në pension. (Zenun Çelaj)

DUSHKAJA. Trevë gjeografike në verilindje të Gjakovës, shtrihet në pjesën lindore të Dukagjinit qendror, territor kodrinor në vargun e sukave-kodrave (Suka e Koznikut,

Suka e Cërmjanit, Suka e Baballoqit-Hereçit), që ndan Gjakovën nga Dukagjini Verior. Kufi natyror e ka Drinin e Bardhë, rrjedhën e poshtme të Erenikut dhe Krahinën e Rekës. Në perëndim, në veri dhe në verilindje kufi e ka rrjedhën e poshtme të Bistricës së Deçanit, e cila e ndan Dushkajën nga Lugu i Baranit. Dushkaja i takon pellgut të Drinit të Bardhë. Në relievin kodrinor dominojnë pyjet e dushkut në lartësi 1.5 m-2.5 m, karakteristikë në Ballkan, të shtrira sidomos në anën e djathtë të Drinit. Mbizotërojnë tokat me pjellori të vogël dhe mesatare të tipit aluvial, toka të murrme, të hirta acide, të kuqe, humusore, smonica liqenore, zallore dhe argjilore, të përhapura në të gjitha anët e tarracave liqenore në lartësi 760-650 m. Në tokat bujqësore kultivohen drithërat, pemët dhe hardhia e rrushit. Dushkaja përfshin 26 fshatra të komunës së Gjakovës dhe të Deçanit. Ndër më të njohurit janë: Kralani, Bardhaniqi, Palabardhi, Vranoci etj. Në këtë zonë janë gjetur gjurmë të vendbanimeve nga koha e parahistorisë deri në mesjetë, siç është qyteza e fortifikuar e Sukës së Cërmjanit (antika e vonë), pastaj Çuka e Hereqit dhe Gradisha e Fshejit. Klima është kryesisht kontinentale mesatare, me dimra të lagësht, të ftohtë, vera të nxehta, relativisht të thata. Liqeni artificial i Radoniqit (1985) ka ndikuar dukshëm në mjedisin e kësaj zone. (Nesim Vala)

DUSHKU Elvira (1982-). Gazetare e sportit, basketbolliste. Lindi në Prishtinë. Kulmin e karrierës sportive e arriti në klubin e basketbollit "Universiteti" të Prishtinës (1996-2007). Gjatë kësaj periudhe me këtë skuadër fitoi 7 trofe të kupës së Kosovës dhe 6 tituj të kampionit. Për shumë vjet ishte basketbollistja më e mirë në Kosovë e shpallur nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK). Pas përfundimit të karrierës aktive u angazhua në KB "Sigal Prishtina" (ish-Universiteti) në cilësinë e trajneres dhe më pas të bashkërendueses së skuadrës, detyrë që e kryen edhe tani. Gjatë periudhës 2007-2014 E. Dushku ka qenë përzgjedhëse e përfaqësueses së Kosovës në basketboll për grupmoshat U-14, U-16 dhe U-18 në konkurrencën e femrave. Që nga viti 2007 punon gazetare e sportit në të përditshmen "Kosova sot". (Gani Kosumi)

DUSHKU Qazim (1932-2007). Mësimdhënës i artit figurativ, këngëtar. Anëtar i Korit "Collegium Cantorum", i korit profesional të

Radiotelevizionit të Prishtinës dhe i Oktetit "Prishtina". Këndoi këngë popullore dhe të muzikës së lehtë. Nga repertori i tij dallohen këngët: "Kam dyzet vjet", "Dalngadalë po vjen behari" dhe ajo popullore qytetare: "A del për mu' pranvera". Trajtimi i tyre lidhet me përjetimet dhe jetën e njerëzve tanë, lufta për liri, burgu etj. Kompozoi dhe shkroi tekste këngësh, nga të cilat shquhen: "Bari e fyelli" dhe "Pishat e Deçanit". Po aq bukur e ka realizuar dhe këngën "Struganes", të kompozitorit I. Hoxha, me tekst të N. S. Hoxhës. Ndjeshmërinë dhe lirizmin e ka shprehur në këngët popullore qytetare, siç është kënga "Kur hëna del". (Besa Luzha)

DUSHQET. Janë lloje bimore të gjinisë dushk (*Quercus*), përbërësit kryesorë të pyjeve të dushkut. Në Kosovë është mjaft e përhapur në zonën përkatëse fitoklimatike të lartësisë mbidetare 400-1, 200 m, por gjithashtu edhe mjaft të degraduara. Janë forma drunore gjetherënëse. Gjethet i kanë me vendosje të këmbyer, me buzë të dhëmbëzuara, kurse lulet njëseksore. Lulet mashkullore janë të vendosura në levarë të varur me shumë lule, kurse ato femërore të veçuara, ose me pak lule (2-5). Lulet kanë perianth të thjeshtë dhe polenizohen me anë të erës. Fryti, arrëz e vetme e futur në një gishtje (zhguall) quhet lende. Dushqet jetojnë gjatë 700-900 vjet dhe dallohen për vlerën e madhe ekonomike dhe përdorim të shumëfishtë. Ndër llojet më kryesore në florën e Kosovës janë shparthi, qarri, bingu, bungëbuta, bulgëri. Shparthi është dru i lartë 25-30 m, me diametër rreth një metër. Ndeshet kudo në Kosovë, ku krijon bashkësi pyjore me lloje të tjera, sidomos me qarrin, që paraqet bashkësinë klimazonale të zonës së dushkut. Qarri është dru i lartë 30-35 m, me diametër deri në 2 m, me lëvore të murrme dhe të çarë te formatet e vjetra. Formon pyje të përziera me lloje të tjera drunore. Bingu është lloj mjaft i përhapur në Kosovë, i lartë 30-40 m, me diametër 1-2 m. Në lartësinë mbidetare 800-1000 m krijon bashkësi pyjore me përbërje të ndryshme floristike. Bungëbuta është i ngjashëm me bingun, me lartësi deri 20 m. Me dushqe e forma të tjera drunore krijon pyje të përziera. Bulgëri në Kosovë përfshin sipërfaqe të pakta, në lartësinë mbidetare 400-900 m, në rrëzat e Pashtrikut, të Koritnikut dhe të Oshlakut. (Feriz Krasniqi)

DYLA Besim (1933-2011). Pedagog, mësimdhënës. Lindi në Gjakovë, ku kreu edhe shkollën fillore dhe progjimnazin. Kreu edhe shkollën normale në Prizren dhe studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik në Shkup. Fillimisht ishte mësues. U angazhua në seminare e kurse pedagogjike për kualifikimin e rikualifikimin e mësuesve në qendra të ndryshme të Kosovës. Ishte mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Shkollën e Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" në Gjakovë. U mor edhe me studime dhe publikime nga fusha e pedagogjisë dhe e didaktikës, ndër të cilat janë edhe tekstet mësimore: "Pedagogjia" (1995), "Didaktika" (1995), "Struktura e elementeve mësimore" (1996), "Didaktika e vlerësimit të përparimit të nxënësve" (1997) etj. (Valentina Nimonaj-Hoti)

DYNDJA "E MADHE" SERBE NGA KOSOVA (1690). Tezë e historiografisë serbe, sipas të cilës, pas tërheqjes së ushtrisë austriake nga Kosova, gjatë luftërave austro-osmane (1683-1699), në dimrin e vitit 1690, patriku serb Arsenije III Černojeviq, me një numër murgjish, në krye të 37 mijë familjeve serbe (400 deri 500 mijë banorë) u dyndën nga Kosova, ndërkaq shqiptarët, të ndihmuar nga administrata osmane, zbritën nga malet e Shqipërisë dhe populluan Rrafshin e Dukagjinit, Rrafshin e Kosovës dhe Maqedoninë, duke zënë hapësirat e serbëve të shpërngulur. Teza u mbështet gjerësisht nga Monarkia e Serbisë në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në kohën kur Perandoria Osmane ishte në shpërbërje, ndërsa shtetit serb synonte të përligite pushtimin e territoreve. Teza nuk kishte ndonjë argument historik apo shkencor, por u mbështet në një dorëshkrim (manuskript) të Manastirit të Shishatovacit në Frushka Gorë, shkruar nga një murg serb, tri dekada pas luftës së viteve 1689-1690, i cili shquhet për një mori pasaktësish historike. Burimet historike të proveniencës perëndimore (austriake, hungareze, italiane etj.), pastaj burimet osmane (kronikat dhe dokumentet zyrtare), si dhe burimet serbe (letra e Arsenije Černojeviqit drejtuar perandorit austriak në vitin 1706) saktësojnë se pas rënies së Beogradit, në Hungari u shpërngulën 30 deri në 40 mijë veta (pra, jo familje), shumica dërrmuese nga zona ndërmjet Beogradit dhe Nishit. Deri më sot vetëm një numër i vogël historianësh serbë e mohuan (Jovan Tomiq) apo e relativizuan (Tihomir R. Gjorgjeviq,

Rajko L. Veselinoviq, Dushanka Bojanic) të ashtuquajturën “dyndje e madhe serbe” nga Kosova. Kjo tezë e deformuar e historiografisë serbe u përdor gjerësisht nga nacionalizmi serb deri në kohët e vona, për të arsytuar politikat hegjemoniste në Ballkan, veçmas në raport me Kosovën dhe shqiptarët. (Gazmend Rizaj)

DYNDJET BULLGARE. Pjesa me e madhe e historianëve pajtohen se bullgarët kanë origjinë turanike (nga Azia Qendrore, mbase me elemente iranike). Prej andej bullgarët, bashkë me hunët, arritën në stepat europiane, në perëndim të lumit Volgë (370). Duke shkuar drejt perëndimit, rreth vitit 460, ata kaluan në veri dhe në lindje të detit Azov. Në vitin 480, Bizanti i rekrutoi bullgarët në luftë kundër ostrogotëve. Prej atëherë bullgarët sulmuan disa herë provincat e saj danubiane. Avarët, që depërtuan nga Azia në Europën e Mesme, asgjësuan njërin nga fiset bullgare. Fiset e tjera u kthyen prapa në Azi dhe atje krijuan Kanatin e fuqishëm, nën udhëheqjen e Kubratit (605-642). Pas vdekjes së Kubratit, pesë djemtë e tij ndanë mbretërinë në pesë pjesë, të quajtura hordhi, prej të cilave vetëm njëra i mbijetoi kohës. E para, që shtrihej në brigjet e detit Azov u shkri në Perandorinë e Hazarëve; e dyta iu bashkua avarëve në Europën Qendrore; e treta hyri në shërbim të longobardëve në Itali; e katërta, nën udhëheqjen e Katrogut, depërtoi në veri në ultësirën midis lumenjve Volgë e Kam dhe u asimilua nga rusët. Hordhia e pestë, nën udhëheqjen e prijësit Asparuh, depërtoi në perëndim të lumit Dnjestër dhe më pas shkoi në jug dhe u vendos në ultësirën midis lumit Danub dhe maleve Ballkan. Kjo, në fakt, përbënte thelbin e Perandorisë së Parë Bullgare (shek. VII-XI), e cila më 681 u njoh si e tillë zyrtarisht nga Perandoria Bizantine. Nën sundimin bullgar ishte edhe territori i sotëm i Kosovës, si dhe trevat e tjera arbërore gati për tre shekuj (IX-XIII), me ndërprerje. (Ramiz Abdylj)

DYNDJET GOTE. Gotët ishin popullsi gjer-manike. Vendi i origjinës së tyre ishte Gadishulli i Skandinavisë dhe brigjet e Baltikut. Janë të njohura dyndjet e tyre në drejtim të jugut (shek. I-II). Pas ngulitjes në treva më jugore nga vendi i origjinës, në vitin 375, gotët do të ndahen në ata të Lindjes (Ostrogotët, *Greutunge*) dhe të Perëndimit (Vizigotët, *Tervinge*). Në Dardani i ndeshim për herë të parë në vitin 269, kur perandori Klaudi II i kishte mundur afër

Nishit (Naissus) të Dardanisë. Aureliani ishte detyruar t’ua linte Dacinë (275). Ostrogotët, së bashku me hunët, bënë shkatërtime të mëdha në Europë. Pas vdekjes së Atilës (453), u ngulitën në Hungari, që nga andej paraqitnin rrezik të përhershëm për Bizantin. Në krye me Teodorikun kaluan në Itali, ku themeluan shtetin e tyre me seli në Ravenë (493), të cilin do ta shkatërrojë shumë shpejt perandori Justiani I. Dyndjet ostrogote i ndeshim edhe në provinca jugore të Ilirikut: Dardani, Preval dhe Epir. Burimet historike dëshmojnë se gotët kishin rrënuar dy herë Ulpianën (471 dhe rreth 500). Dëshmitë materiale ostrogote të zbuluara në këtë qendër provojnë edhe për kolonizimin e përkohshëm të tyre në këtë hapësirë. (Faik Sahiti)

DYNDJET HUNE. Popullsi baritore më orgjinë mongole, e cila nga gjysma dytë e shek. IV, nga trevat e Azisë Qendrore, kaloi lumin Vollga dhe Don për të depërtuar në Europë. Hunët në kohën e Atilës (rreth 395-453) kishin krijuar mbretërinë e madhe, që përfshinte zona nga Danimarka deri në Panoni, nga Laplandi dhe Rajna deri te deti Kaspik. Më 441-442 hunët shkatërruan Dardaninë (Mezinë), Ilirikun dhe Trakën, ndërsa më 447 depërtuan në Termopile. Brenda pak vitesh hunët pushtuan, grabitën dhe rrënuan një numër të madh qytetesh të Maqedonisë dhe veçanërisht të Dardanisë. Prisku, një historian bizantin (rreth 415-472), ofron të dhëna interesante për oborrin e Atilës në zona të Dardanisë, si dhe për pushtimet dhe shkatërrimet e tij në këtë provincë. Përveç plaçkës, hunët morën me vete edhe robër lufte. Në mesin e tyre ka njoftime edhe për ilirët nga zonat bregdetare. Më 441-442 hunët kishin rrënuar edhe Nishin, një ndër katër qytetet më të mëdha të Dardanisë të asaj kohe. Përmes përdorimit të “kryedeshëve” arritën të shkatërronin pjesërisht qytetin dhe ta pushtonin atë. Por, me shkatërrimin e shpejtë të federatës hune, pas vdekjes së Atilës, pushuan sulmet e tyre kundër Perandorisë Romake. (Faik Sahiti)

DYNDJET KUMANE. Dyndje drejt veriut e pjesëtarëve të grupit nomad turk të degës perëndimore të Konfederatës Kipçak. Kumanët fillimisht shtriheshin në pjesën veriperëndimore të Azisë. Rreth vitit 1100, nën trysninë mongole, depërtuan në Vllahi dhe

Moldavi, prej nga sulmuan Rusinë dhe Kievin, Mbretërinë Hungareze, Trasilvaninë Juglindore, Perandorinë Bizantine dhe, në këtë kuadër, edhe trevat shqiptare. Shtetin e tyre e formuan në territorin e Vllahisë, ku princi kuman Bark, me 15,000 njerëzit e tij, pranoi krishterimin (1227), duke formuar peshkopatën kumane (Kumania). Kumanët, pas disfatës nga mongolët në betejën pranë lumi Kalki (1238), kaluan në Hungari (1239-1245). Mbreti i këtij vendi, Bela IV (1235-70), mori titullin “Mbret kuman” (rex Cumaniae) dhe i vendosi ata përgjatë lumit Tisa e Danub (Vojvodinë) për të mbrojtur kufirin nga sulmet mongole. Pjesa tjetër e kumanëve u vendos në Bullgari, Traki dhe në Azinë e Vogël. Supozohet se disa perandorë të Perandorisë së Dytë Bullgare (1186-1396) ishin me origjinë kumane. Kumanët, duke qenë me origjinë të afërt me hungarezët, vazhduan të jetonin në një territor kompakt të këtij shteti (Kumania e Vogël dhe Kumania e Madhe). Megjithatë, deri në gjysmën e shek. XIX, shumica e kumanëve në Hungari u asimiluan. (Ramiz Abdyli)

DYNDJET SLLAVE. Gjatë shek. VI-VII treva e Kosovës së sotme u ballafaqua me vërshimin e popujve “barbarë”. Së pari kjo trevë u përball me dyndjet e “barbarëve” josllavë, ndërkaq shpërngulja e sllavëve pati si pasojë vendosjen e tyre në hapësira të gjëra të Dardanisë së Sipërme dhe ndërrimin e strukturës etnike dhe shoqërore-ekonomike të Gadishullit Ballkanik. Prokopi (*De Bellum Gothicum*) e paraqet vitin 545 si datë fillestare për zbritjen e sllavëve në jug të Danubit. Ushtritë sllave, saktëson Prokopi, kaluan Danubin (547-548) dhe zbritën në Ilirik deri te Durrësi. Në vitet 550-551, shumica e sllavëve u paraqitën në Ilirik, për të mbetur aty për një kohë të gjatë, “duke zënë shumë robër dhe duke plaçkitur çdo gjë”. Si pasojë e këtyre sulmeve, një numër i qyteteve u dëmtuan rëndë.

Në mungesë të një ushtrie të mjaftueshme për t’u bërë ballë sllavëve, perandori Justiniani I ngriti sistem të dendur fortifikatash. Për këtë qëllim vetëm në provincat jugore ilire të Dardanisë, Prevalit, Epirit të Ri dhe Epirit të Vjetër ndërtoi dhe rindërtoi 167 fortifikata. Treva e Kosovës së sotme pjesërisht ishte kursyer nga sulmet e para, për shkak të maleve që e rrethonin, funksionimit të rrugës së mbrojtur Nish-Lezhë, ndërtimit të qytetit të ri Justinopolis, si dhe rindërtimit të Justinianës së Dytë. Por në

kohën e perandorit bizantin Herakël (610-649) ndodhën ngulitjet masive të sllavëve në viset të ndryshme të Ballkanit. Nga kjo kohë, sipas “Mrekullive të Shën Dhimitrit”, në vitin 618, në rrethinat e Selanikut kishin gjetur strehim shumë të arratisur nga provinca e Dardanisë. Mirëpo, gjetja e një solidi të perandorit Herakël në Ulpianë, bën të ditur se ky qytet u kishte mbijetuar sulmeve sllave nga gjysma e parë e shek VII. Nga dyndjet e shek. VI-VII, sllavët e ardhur nuk arritën të krijojnë ndonjë organizim politik. Trevat ku u përqendruan ata u quajtën “Sclavini” ose “Sclavinica”, siç u quajtën në rrethet e Selanikut dhe në Trakë. Sllavët e ardhur ndryshonin nga banorët autoktonë për nga mënyra e jetesës. Gjatë periudhës së dyndjeve sllave, të cilat u përcollën edhe me shkatërrime dhe plaçkitje, kishte degraduar dukshëm potenciali ekonomik vendor. Veçanërisht ishte zvogëluar numri i kafshëve dhe nga bujqësia e zhvilluar u kalua në blegtori dhe bujqësi primitive. Sllavët, pasi u vendosën në këto hapësira, morën nga vendorët edhe shumë elemente të kulturës materiale. Mundësitë për huazime në prodhimtarinë zejtare ishin më të vogla, meqë shumë qytete tashmë ishin rrënuar tërësisht. (Jahja Drançolli)

DYSELJE Alen (Alain Ducellier) (1934-). Historian francez, bizantolog, profesor universiteti. Profesor i Universitetit “Le Mirail” (Francë) në Tuluz, specialist i Bizantit dhe i botës së krishterë të Lindjes. Hulumtoi në shumë arkiva dhe mori pjesë në konferenca të ndryshme shkencore. Si rezultat i hulumtimeve të thelluara, botoi një sërë monografish: “Bizantinët: Historia dhe kultura” (1988), “Kisha bizantine: Ndërmjet fuqisë dhe shpirtit 313-1204” (1990); “Të krishterët e Lindjes dhe Islami në mesjetë, shek. VII-XV” (1996); “Bizanti dhe bota ortodokse” (1997) etj. Është edhe bashkautor i disa monografive. A. Dyselje është një zë i fuqishëm i vijimësisë së shqiptarëve nga ilirët në mesjetë. Studimet e tij janë botuar në revista të njohura të botës dhe janë përmbledhur në një vëllim të veçantë: “Shqipëria ndërmjet Bizantit dhe Venedikut, shek. X-XV” (1987), ndërsa vepra e tij kryesore është “Dalja në det e Shqipërisë në mesjetë: Durrësi dhe Vlora nga shek. XI deri në shek. XV” (1981). Shkroi tekste në mbështetje të Kosovës edhe gjatë viteve ’90. Është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. (Qerim Dalipi)

DH

DHIA E EGËR. (*Rupicapra rupicapra* L.) Ka origjinë nga Azia. Jeton pothuajse në të gjitha malet e larta të Europës. Në Kosovë ka shtrirje në malet e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna,



në brezin e fundit të pyjeve dhe kullotave alpine. Dhia e egër është përshtatur shumë me mjedisin në të cilin jeton. Trupi i dhisë së egër ka gjatësi 110-140 cm, lartësia nga 90-110 cm. Meshkujt janë rreth 10% më të mëdhenj se femrat. Jeton në kope dhe ushqehet me baroja, gjethe, shkurre, filiza të rinj të drurëve. Çiftëzimi bëhet në vjeshtë. Është kafshë shumë e gjallë, e lëvizshme dhe frikacake. Në Kosovë është ndaluar gjuetia e dhisë së egër. (Ibrahim Muja)

DHIA. (*Capra hircus*) Të gjitha dhitë shtëpiake kanë prejardhjen nga dhia e egër *Capra prisca*, që paraqet formën e dhisë së egër, prej së cilës e ka prejardhjen dhia e sotme e Ballkanit. Kosova ka një traditë në kultivimin e dhive, por si në sektorë të tjerë të ekonomisë edhe kjo fushë ka përjetuar periudha të rënies dhe të ngritjes. Rënie drastike të numrit të dhive ka pasur në periudhën e viteve pesëdhjetë, si pasojë e aksionit të zhdukjes së dhive për

mbrojtjen e pyjeve. Më vonë vërehet një trend pozitiv i rritjes së numrit të dhive, kryesisht të mbarështuara nëpër fermat e vogla familjare dhe disa racave me prodhimtari të lartë nëpër fermat shtetërore (dhia e Sanës dhe Alpine). Ulje e ndjeshme e numrit të dhive në Kosovë evidentohet edhe gjatë periudhës së luftës së fundit në Kosovë (1998-1999). Por pas luftës, me ndihmën e shumë organizatave ndërkombëtare, ky sektor ka filluar sërish të gjallërohet. (Ragip Kastrati)

DHOMI Ajmone (1946-). Pedagogë e muzikës. Lindi në Pejë. Kreu Akademinë Pedagogjike në Sarajevë (1972) dhe studimet e magjistraturës në Universitetin e Tetovës (2008). Mësimdhënëse në Shkollën Normale në Pejë, në Sarajevë, në shkollën fillore në Hrasnica, në Shkollën Normale dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Deri në pension ishte mësimdhënëse e edukatës muzikore në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, mësimi klasor dhe parashkollor. Si pedagogë u shqua me formimin e korit, ansambleve dhe paraqitje me to në gara, koncerte e festivale. U shpërblye me çmime dhe mirënjohje, ndër të cilat edhe çmimi i tretë në garat republikane korale në Sarajevë (1970). Është autore libreti për operat “Goca e Kaçanikut” dhe “Dasma arbëreshe”, si dhe oratoriumit “ABCD”, e tekstit për kantatën “Uratë vajzave”. Ka hartuar tekste metodike: “Metodika e edukatës muzikore” (2000), “Edukata muzikore” për kl. V (2007), “Sintezizer për fillestarë” (2001), “Prej Notës deri te Kënga” (2008) “Lojrat muzikore të kënduara” (2009), “Lojrat muzikore me karakter humori” (2010), “Ligjerimet ritmiko-melodike” (2012). Ka hartuar dy tekst në alfabetin e Brajtit për nxënës të verbër, me të cilët punon aktivisht, duke organizuar shfaqje e koncerte. (Besa Luzha)


DHOMI Arbër (1972). Dirigjent. Lindi në Gjakovë, ku mori mësimet e para për muzikë, që më pas i vazhdoi në Prishtinë. Në Shkup e vazhdoi shkollimin e mesëm për perkusione.



ARBËR DHOMI

Më pas vazhdoi studimet e larta në Zwoole të Holandës, për dirigjim orkestral. U specializua në *Uitvoerend Musicus* dhe për dirigjim operistik e simfonik në *Franzliszt Academy* në Vaimar, Gjermani. Studimet master për dirigjim i përfundoi në Zwoole (2015). Punoi si dirigjent dhe asistent në Holandë në kuadër të orkestrës së studentëve Bragi, me trupën *Operette van Veendam Newman Ensemble* për muzikën bashkëkohore. Në konkursin ndërkombëtar për orkestrat harkore në Shqipëri është shpërblyer me çmimin II, bashkë me orkestrën e harqeve të Filharmonisë - Operës së Kosovës. Shquhet me dirigjimin e veprave të mëdha operistike dhe orkestrale si “*Nabuko*” e Giuseppe Verdit në Opera Ślaska Bytom në Poloni, opera *Anna Frank-Handenberg City Theatre* e Zwolle *De Spiegel Theatre-Holandë*, dirigjimin e inskenimit të parë operës në Kosovë, inskenimin e operës “*Carmen* e Ali Pashë Tepelena” në Prishtinë, koncertin me Inva Mulën me orkestrin e Filharmonisë dhe Operas së Kosovës dhe koncertin për 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Punon në *Muzisch centrum, Emmeloord* (Holandë) si koordinator artistik i *Messiaen Academie* dhe në konservatorin *Artez* (Holandë). (Besa Luzha)

DHOMI Rauf (1945-). Kompozitor, profesor universiteti, akademik. Lindi në Gjakovë. Pas shkollës fillore në vendlindje vazhdoi Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, ndërsa studimet



RAUF DHOMI

universitare për kompozim dhe dirigjim i kreu në Akademinë e Muzikës në Sarajevë. Në po atë akademi vazhdoi me studimet pasuniversitare, që i përfundoi më 1972. Ishte themelues dhe drejtues i Korit të Burrave të Gjakovës

(1965). Kompozoi operën e parë “*Goca e Kaçanikut*”(1972). Nga viti 1971 punoi në

Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë deri në hapjen e Akademisë së Arteve (1975), ku vazhdoi punën si profesor. Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ishte drejtues i Filharmonisë dhe Operës së Kosovës (2003-2007). Në krijimtarinë e tij muzikore vend qendror zunë veprat vokale dhe vokale-instrumentale. Është autor i tri operave dhe katër baletëve. Kompozoi pothuajse në të gjitha gjinitë muzikore: këngë korale, muzikë instrumentale e pianistike, muzikë vokale-instrumentale, muzikë kamerale, përfshirë edhe veprat muzikore-skenike. Veprat korale, vokale-instrumentale: “*Requiem*”, për solistë vokalë dhe orkestër (1968); “*Te mullini përmbi vijë*”, për solist dhe kor i përzier (1969); “*O po gjeta një bilbil me vesë*”, solist dhe kor i përzier (1977); botoi librin “*Këngë korale patriotike*”, për kor meshkujsh (1981); “*Lamtumirë*” këngë mortore, për kor të përzier (1982); “*Vatra e urtësisë*”, për solistë vokalë, kor, recitues e orkestër (1985); “*Uratë vashave*”, për solistë vokalë e orkestër. Veprat solistike-kamerale: *Rondo* për violonçel e orkestër simfonike (1965); *Sonatë* për piano (1966); *Kuartet harkor* (1968); *Elegji* për violinë, soprano ose tenor e piano (1970); “*Vjeshta*”, për zë e piano (1970); “*Kopshti i dashurisë*” për zë e piano (1985); “*Nocturno albanese*” për piano (1999); “*Impresione dardanë*” për piano (1990-99); *Temë me va riacione* për violinë solo (2001), *Trio in A*, për flaut, violinë e violë (2002). Veprat orkestrale: *Rondo*, (1965), *Skercio* (1966), *Uvertura Solemne* (1969), *Epopeja* (1978), *Uvertura nga opera Goca e Kaçanikut* (1972), *Suitë simfonike* (1993-94). Veprat muzikore-skenike: “*Goca e Kaçanikut*”, operë me dy akte me libretin e A. Dhomim sipas novelës së M. S. Gurra (1972); “*Dasma arbëreshe*”, operë me tri akte, libreti A. Dhomi sipas G. del Gaudio (1982-83); “*E bukura morë*”, balet me tri akte (1984). Ka kompozuar muzikën për filmat “*Kur pranvera vonohet*” (1975), “*Gjurmët e bardha*” (1976), “*Njeriu prej dheu*” (1979), “*Tre vetë kapërcejnë malin*” (1980) “*Kodi i jetës*” etj. Muzika e tij është shfaqur në Kosovë, Shqipëri, Portugali, Spanjë si dhe në vende të ish-Jugosllavisë. Është shpërblyer me çmime e mirënjohje. (Rreze Kryeziu-Breznica)

DHOMI Trimor (1976-). Kompozitor. Lindi në Gjakovë. Studjoi komponimin në Akademinë e Arteve në Tiranë, studimet master

i kreu në Shkup. U angazhua si ligjërues e pastaj edhe profesor në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2003), për muzikë aplikative. Ka hartuar muzikë për filma dhe shfaqje teatrore, ndër të cilat: “Shfaqja e fundit” me regji të F.Hysajt, “Nata e dymbëdhjetë” me regji të I. Bokshit, “Rock&Roll” me regji të D. Mustafiq, pastaj “Më shiko në sy”, “Shok” etj. Komponon vepra vokale, vokalo-instrumentale, solistike, kamerale, simfonike, baletë e opera si: “Melody” (fitues në garën për ekzekutim e incizim nga Sidney Contemporary Orchestra/Australi 2016), “Into a Dream” (fitues në garën për ekzekutim e incizim nga Filharmonia e Brnos, Çeki 2017) dhe i operave kamerale “Fryma e fundit” dhe “Pasqyrja”. (Besa Luzha)

DHUNA NË FAMILJE. Është sjellje që synon kontrollin ndaj anëtarëve të familjes, duke keqpërdorur fuqinë, për të krijuar marrëdhënie të pabarabarta ndërmjet anëtarëve të familjes dhe partnerëve. Është fenomen kompleks, që shfaqet në forma të ndryshme: si dhunë fizike, psikologjike, emocionale, ekonomike dhe seksuale. Format e dhunës në familje ndryshojnë varësisht nga vendi, kultura, konteksti dhe rrethanat. Ajo ndodh në të gjitha kulturat dhe kohët, por vërshtirë dokumentohet, meqë zakonisht ndodh larg syrit publik dhe në shumë shoqëri konsiderohet ende si çështje private e partnerëve në martesë apo e familjarëve. Si e tillë, dhuna në familje bëhet e padukshme që dhe nuk paraqitet realisht në statistikat zyrtare. Dhuna në familje, në rrafshin global dhe nacional, prek më së shumti gratë dhe fëmijët, por nuk përjashton edhe të moshuarit, si dhe personat me nevoja të veçanta. Sipas hulumtimeve, në Kosovë nuk i shpëtojnë dhunës në familje as burrat, por shumë më pak dhe me më pak pasoja se gratë dhe fëmijët. Abuzuesit e dhunës në familje vijnë nga struktura të ndryshme ekonomiko-shoqërore, kulturore dhe arsimore. Si rezultat i avokimit publik të lëvizjeve të grave dhe ngritjes së dukshmërisë së dhunës në familje, sidomos pas luftës së fundit, kjo dhunë në Kosovë ka filluar të raportohet. Tashmë ajo konsiderohet edhe në Kosovë si shkelje e të drejtave të njeriut dhe ndëshkohet me ligj. Në Kosovë është krijuar një zinxhir i institucioneve që fillojnë me shërbimet e specializuara policore, gjyqësorin dhe strehimoret, të cilat e marrin përsipër mbrojtjen e viktimës dhe

rehabilitimin e tyre. Megjithatë, në Kosovë dhuna në familje kërkon një qasje specifike pikërisht nga fakti se normat zakonore, të cilat kanë dominuar skenën shoqërore një kohë të gjatë, e kanë legjitimuar dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve. Gruaja, por sidomos fëmijët, janë trajtuar pronë e zotit të shtëpisë, burrit/babait etj., që, si element i krijimit të raporteve ndërfamiljare nuk është konsideruar si shkelje e të drejtave të njeriut. Normat zakonore e kanë gjykuar vetëm dhunën e tepruar fizike, ndërsa për dhunën psikologjike as që është bërë fjalë. Por pas vitit 1999, infrastruktura e re ligjore, prezenca e ndërkombëtarëve, shoqëria civile dhe lëvizjet e asociacioneve të grave kanë ndikuar që në Kosovë të inkurajohet gruaja për të kërkuar mbrojtjen e saj dhe kategorive të rrezikuara nga dhuna. (Vjollca Krasniqi)

DHURATA. Element i filantropisë, marrje dhe kthim i vlerave, që synon krijimin e raporteve sociale që shkojnë përtej vlerave reale të vetë dhuratës. Njihet si njëra ndër universalet kulturore, që ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë në të gjitha kulturat njerëzore. Shkëmbimet e tilla e transcendentojnë ndarjen ndërmjet shpirtërores dhe materiales. Dhënësi nuk dhuron thjesht një objekt, por edhe pjesë nga vetja e tij, meqë objektet e dhuruara asnjëherë nuk ndahen plotësisht nga njeriu, i cili i dhuron ato. Për shkak të kësaj lidhjeje ndërmjet dhuruesit dhe dhuratës, akti i dhurimit krijon një lidhje shoqërore duke marrë obligimin që të shkëmbejë vlera reciproke. Dhënia e dhuratës është shprehje e gatishmërisë për pajtim, për tejkalimin e armiqësisë dhe të konfliktit, ose për krijimin e lidhjeve të reja pozitive sociale. Ndërsa kthimi i dhuratës merret si ndërprerje e armiqësive reciproke, por edhe si mjet i manifestimit të superioritetit të vet. Dhurata është edhe element i shtrirjes së dominimit mbi marrësin, meqë dhurata asnjëherë nuk jepet falas. Në traditën popullore shqiptare, pas mbylljes së konflikteve ndërfamiljare, zakonisht procesi ka përfunduar me një gosti, apo me zyrtarizimin e ndonjë elementi institucional jashtë strukturës fafësnore (vëllamëri, kumbari apo miqësi ndërmjet familjeve të pajtuara), ku janë këmbyer edhe dhurata. Në Kosovë dhe gjetiu festat dhe ritet e tjera (qofshin ato dasma, lindje apo morte) vazhdojnë të ruajnë zakonin e lashtë të këmbimit të dhuratave. (Anton K. Berishaj)

E

EDICIONI “NË FLAKËN E REVOLUCIONIT”. Edicion i Institutit të Historisë së Kosovës për Luftën Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe lëvizjen komuniste në Kosovë. Botimet u bënë në dy gjuhë paralelisht, shqip dhe serbisht. Në këtë edicion u botuan biografitë e heronjve dhe të luftëtarëve të rënë në LNÇ gjatë viteve 1941-1945. Dy numrat e parë i botoi Lidhja e Shoqatave të Luftëtarëve të LNÇ-së të Kosovës më 1966 dhe 1968. Nga viti 1973, Enti i Historisë, përkatësisht Instituti i Historisë së Kosovës e mori përsipër vazhdimin e botimit. Personat për të cilët u shkruan biografitë ishin kryesisht nga Kosova, por u përfshinë edhe luftëtarë të rënë gjatë LNÇ-së nga Shqipëria dhe Maqedonia, që luftuan në kuadër të njësiteve të LNÇ-së të Kosovës, që u pushkatuan ose u vranë në Kosovë, apo u dërguan në kampe përqendrimit në Gjermani, ku gjetën vdekjen. Deri në vitin 1984 u botuan 11 libra në shqip dhe serbokroatisht, në të cilat u përfshinë 1,127 luftëtarë dhe heronj të popullit. Shkrimi i biografive të luftëtarëve bëri të ndriçoheshin ngjarje të ndryshme jo vetëm të viteve 1941-1945, por edhe ngjarje të periudhës midis dy luftërave botërore, duke u sqaruar kështu edhe shumë vrasje me motive politike, si vrasja e Meto Bajraktarit, masakrat e Tivarit e të Vërshacit, të Kikindës etj. Kryeredaktore e edicionit ishte Vahide Hoxha, redaktor Fehmi Pushkolli. (Fehmi Rexhepi)

EFENDIA Gani (1931-2004). Mjek, infektionist, primarius. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Në vitin 1951 regjistrohet në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd, por i ndërpreu studimet dhe punoi për 10 vjet pedagog në gjimnazin e Gjakovës. Në moshën 30-vjeçare i vijoi studimet në mjekësi të

përgjithshme në Beograd. Nga viti 1968 punoi si mjek në Qendrën e mjekësisë “Isa Grezda” në Gjakovë. Emërohet pastaj drejtor i Shtëpisë së Shëndetit në Gjakovë, ku dha kontribut të çmuar për konsolidimin e këtij institucioni. Gjatë viteve 1981-1985 ishte deputet i Kuvendit të Kosovës. U specializua në infektologji dhe ishte themelues i shërbimit infektologjik për Gjakovën dhe në këtë pjesë të Kosovës. Botoi një sërë punimesh profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Shemsedin Dreshaj)

EFENDIJA Minir (1946-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Diplomoi në degën e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1970. Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit të doktoratës i mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981). Ishte i angazhuar asistent në Fakultetin Elektroteknik të UP-së dhe më pas u zgjodh ligjërues dhe pastaj profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës. Në vitin 1976 zgjidhet ligjërues në FSHMN dhe në vitet vijuese i arrin të gjithë titujt universitarë. Ligjëroi disa kurse në studimet themelore në FSHMN dhe ishte bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Tetovës. Ka botuar punime shkencore e profesionale dhe është hartues i teksteve universitare (“Analiza matematike III dhe IV”, “Përmbledhje detyrash nga analiza matematike II”, “Analiza matematike I”). Ka marrë pjesë në tubime shkencore në vend dhe në rajon. Ka kryer detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë. (Qamil Haxhibeqiri)

EFENDIJA Talat (1937-). Pemëtar, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore

dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa u diplomua në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës, në drejtimin pemëtari-vreshtari (1962). Disa vjet punoi në kombinatin bujqësor “Ereniku” të Gjakovës (1973-1977) dhe më vonë në Institutin Bioteknik në Pejë (1978). Studimet pasuniversitare nga lëmi i pemëtarisë dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Zagrebit. Ndërkohë zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1976), ku gradohet në të gjithë titujt universitarë. Publikoi disa punime shkencore dhe profesionale dhe mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore. Bashkëpunoi në disa projekte investive në ngritjen e pemishteve të reja. Si autor apo bashkautor ka publikuar disa libra për pemëtarinë (“Kultivimi i dredhëzës”, bashkautor; “Pemëtaria e përgjithshme”, “Krasitja e pemëve”). (Agim Zajmi)

EJUPI Mustafa (1927-). Gazetar. Lindi në Prizren. Me gazetari filloi të merrej nga viti 1948, si oficer i ri marinës jugosllave, në gazetën ushtarake “Roja e Adriatikut”. Në vitin 1953 nisi punën në Radio Prishtinë, si njëri ndër gazetarët e parë në gjuhën shqipe. Gjithashtu ishte njëri nga themeluesit e revistës “Zëri i rinisë”, ku botoi shkrime për zhvillimet shoqërore dhe politike. Ishte korrespondent i agjencisë jugosllave të lajmeve “Tanjug”, në fillim nga Prishtina, pastaj nga Moska dhe Ankaraja. (Nehat Islami)

EKAVISHTJA. Një nga tri grupet e të folmeve sllave jugore shtokaviane. Flitet kryesisht në Serbi dhe pjesërisht te serbët e Kosovës në lindje të vijës Pejë-Novi Pazar-Kralevec-Çaçak-Loznicë-Ilok-Sombor-Suboticë-kufi me Hungarinë. Zanorja *jat* e sllavishtes së lashtë në ekavishte është zëvendësuar me *e* të gjatë *ē* (*beo, dete, mleko, seno*), ndryshe nga ijekavishtja (bijelo, dijete, mljeko, sijeno). Është bazë e serbishtes letrare. Pas luftës në Bosnjë në vitet ‘90, serbët e Republika Srpska, që për bazë dialektore e kanë ijekavishten, e kanë zgjedhur ekavishten për gjuhë standarde, në mënyrë që të dallohen nga boshnjakët, kroatët dhe malaziasit. (Naile Mala-Imami)

EKONOMIA CENTRALISTE. Formë kryesore e pronës në socializmin real, respe-

ktivisht etatizmit. Trajtohet edhe si pronë e përgjithshme popullore. Me këtë pronë qeveris shteti, prandaj produktin dhe mbiproduktin e përvetëson shteti, i cili përmes planit qendror vendos për përdorimin dhe shpërndarjen e tij. Ruajtjen fizike të pronës shtetërore dhe rritjen e vlerës së saj shteti e siguron përmes përcaktimit të amortizimit minimal real dhe përmes përcaktimit të akumulimit real minimal në lartësinë e kamatës reale. Në ekonominë centraliste përcaktues kryesorë të vlerave janë organet e larta të shtetit dhe organet e larta të partisë. Ekonomia centraliste gjatë ekzistimit të saj nuk krijoi hapësirën e duhur për zhvillimin e forcave prodhuese, veçanërisht për zhvillimin e demokracisë si formë specifike prodhuese. Në ngecjen e zhvillimit ekonomik dhe të demokracisë kanë ndikuar mungesa e organizimit të ndërmarrjeve, mungesa e strategjisë së investimeve, e cila në literaturë emërohet si “trifurk” dhe që përfshin ndërtimin e objekteve kapitale, marketingun, shpërndarjen dhe vendosjen e punës ekipore, largimin nga kultura botërore e ekonomizimit, e cila nuk duron kontrollin e qarkullimit të ideve, diskriminimin midis njerëzve etj. Kjo formë e ekonomisë u aplikua edhe në Kosovë nga viti 1945 deri në gjysmën e parë të viteve ‘50 të shekullit të kaluar. Por edhe gjatë viteve ‘90, me suprimimin e autonomisë së Kosovës, Serbia bëri centralizimin total të pronës dhe shndërrimin e pronës shoqërore në pronë shtetërore dhe publike. Në të njëjtën kohë u bë edhe integrimi i dhunshëm, pa kritere ekonomike, i ndërmarrjeve me kapital shoqëror të Kosovës me ndërmarrjet nga Serbia, duke i kthyer ndërmarrjet e Kosovës në degë të ndërmarrjeve të Serbisë. (Selman Selmanaj).

EKONOMIA E KOSOVËS. Tërësia e aktiviteve të ndërlidhura të prodhimit, të shërbimeve dhe të konsumit në Kosovë, në kuadër të të cilave burimet (resurset) e kufizuara alokohen përkatësisht përdoren për të përmbushur nevojat e qytetarëve. Kjo përfshin një rrjet të tërë të prodhuesve, ofruesve të shërbimeve dhe të shpërndarësve në nivel të ekonomive familjare dhe të organizatave biznesore, si agjentët kryesorë të ekonomisë së vendit, të cilat organizohen në nivel lokal, komunal dhe nacional. Në Kosovë ka më shumë se 120 mijë biznese të regjistruara (2014), prej tyre rreth 70 mijë me aktivitet të përhershëm



NJË OBJEKT I RI INDUSTRIAL

dhe rreth 300 mijë ekonomi familjare. Këto formësojnë elementet kryesore të ekonomisë së Kosovës. Aktivitetet kryesore ekonomike në Kosovë janë: bujqësia me pjesëmarrje 12%, minierat dhe elektriciteti 16%, tregtia 12.3%, ndërtimi dhe aktivitetet me patundshmëritë afro 16%, administrata publike 10%, shërbimet e edukimit, të shëndetësisë dhe të shkencës 4.4%, transporti dhe shërbimet e akomodimit 5.4%, komunikimi dhe shërbimet financiare 5% , ndërsa rreth 17% e përbëjnë tatimet e taksat në produkte dhe rreth 2% shërbimet e tjera. Një strukturë e tillë e aktiviteteve ekonomike është pasojë e rrethanave historike dhe industrializimit të vonë në vitet '60-'80 të shekullit të kaluar. Pas kësaj periudhe, përgjatë viteve '90, nën pushtetin serb u zhvillua një proces i kundërt që mund të quhet si proces i deindustrializimit, i cili u shoqërua me rënie të aktiviteteve ekonomike për 80%, me shthurjen e institucioneve ekonomike, të sistemit buxhetor dhe të bankave, që kishte për pasojë dezinvestimin e thellë, që kapte më shumë se dy bruto të prodhimeve të brendshme vjetore. Pasojat e luftës në aktivitetet ekonomike dhe në pronën, veçanërisht atë private, ishin po ashtu të mëdha: fondi i banimit u zvogëluar 40%, fondi i bagëtive 50%, pajisjet shtëpiake 70%. Në periudhën e rindërtimit të pasluftës ka pasur një rezultat të konsiderueshëm për tejkalimin e këtyre dëmeve në fondin e banimit, por konsolidimi i aktiviteteve ekonomike, veçanërisht në disa sektorë po shkon shumë ngadalë. Kjo pasqyrohet edhe në peshën e sektorëve të caktuar ekonomikë, të shprehur në përqindjet e pasqyruara më lart, ku qartas shihet pozita e pafavorshme e sektorit të prodhimit. Kjo rrethanë ka lënë pasoja të rënda, sidomos në shpërpjestimet në tregtinë

e jashtme dhe në mundësitë e kufizuara për të krijuar vende të reja të punës. Në ekonominë e Kosovës tani dominon sektori privat (rreth 65%), i cili përfshin sidomos ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në të gjithë sektorët. Sektori publik, përveç administratës dhe shërbimeve publike, përfshin edhe kompani publike që ofrojnë shërbime të infrastrukturës në fushën e elektricitetit, telekomunikimeve, ujit, menaxhimit të mbeturinave dhe ngjashëm. Shumica e minierave dhe një numër i vogël ndërmarrjesh të tjera ende janë në pronësi shoqërore dhe nën përkujdesje të Agjencisë së Privatizimit.

Ekonomia e Kosovës ende mund të konsiderohet si ekonomi në transicion, drejt një ekonomie të lirë të tregut, funksionale e qëndrueshme dhe me kapacitete për të konkurruar në tregun rajonal e më gjerë. Në kuadër të luftës për liri dhe pavarësi, sidomos oponentët e pavarësisë e kanë shtruar çështjen dhe kanë nxitur mëdyshje të mëdha nëse Kosova do të ketë ekonomi të qëndrueshme. Faktet historike dëshmojnë se rritja ekonomike e Kosovës ka qenë proporcionale me mundësinë e kosovarëve që të qeverisin vetveten, si dhe me çështjet që janë të ndërlidhura me stabilitetin politik. Qëndrueshmëria ekonomike në kohët moderne të ndikimit të teknologjisë është më shumë e ndërlidhur me cilësinë e qeverisjes sesa me pasuritë dhe burimet natyrore, ndonëse edhe në këtë aspekt Kosova qëndron relativisht mirë. (Muhamet Mustafa)

EKONOMIA E LIRË E TREGUT. Karakterizohet me lirinë e tregut si rregullator i jetës ekonomike në kushtet e konkurrencës së lirë. Qëllimi kryesor i ekonomisë së lirë të tregut qëndron në krijimin e tregut integral, i cili ka përparësi në krahasim me sistemin ekonomik të socializmit, si në fushën e efikasitetit ekonomik ashtu edhe në fushën e sistemit inovativ. Esenca e ekonomisë së lirë të tregut është tregu financiar. Prandaj ekonomia e lirë e tregut nënkupton liberalizimin e tregut, i cili reflektohet përmes këtyre segmenteve: liberalizimi i çmimeve, luftë kundër çdo forme të monopolit, liberalizimi i marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, krijimi i kushteve të volitshme për depërtimin e kapitalit të huaj, veçanërisht të investimeve të jashtme të drejtpërdrejta, vendosja e marrëdhënieve midis vendeve në transicion dhe të institucioneve

ndërkombëtare financiare, eliminimi i kufizimit të lirive ekonomike etj.

Ndërtimi i ekonomisë së lirë të tregut në Kosovë filloi me shndërrimin e pronës shtetërore në pronën shoqërore dhe të shthurjes së kooperativave bujqësore fshatare (kolkozeve). Aplikimi i kësaj mase solli deri te formimi i sektorit privat në bujqësi dhe në fushën e artizanateve. Pas rënies së socializmit dhe luftës në Kosovë, përmes transformimit dhe privatizimit të pronës shoqërore, sektori privat u shtri edhe në degët e tjera të ekonomisë, gjë që çoi deri te forcimi dhe zgjerimi i sektorit privat. Me zgjerimin e ekonomisë së lirë të tregut u zgjeruan edhe marrëveshjet e tregtisë së lirë midis Kosovës dhe vendeve të tjera, u bë anëtarësimi i Kosovës në CEFTA (Marrëveshja e Europës Qendrore për Tregti të Lirë), në Paktin e Stabilitetit, në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Botërore dhe në organizatat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare. Përveç tregut të mallrave dhe të shërbimeve, pas luftës në Kosovë filloi edhe zhvillimi i tregut financiar dhe i tregut të fuqisë punëtore, por me një intensitet më të ulët. Edhe përkundër emetimit të bonove të thesarit, investimeve portfolio, pozicionit pozitiv ndërkombëtar të investimeve, prapëseprapë transaksionet financiare të këtij tregu kryesisht mbështeten në depozitat dhe dhënien e kredive të thjeshta dhe jo në aplikimin e derivateve të tjera financiare. Gjithashtu edhe tregu i fuqisë punëtore ndodhet në fazën iniciale. Në situatën e tanishëm të këtij tregu ka ndikuar norma e lartë e papunësisë (në vitin 2013 kjo normë ishte 30.9%), pastaj pagat e ulëta, diferencat e mëdha në pagat për punët e njëlljoita, diferencat e vogla midis punëve të thjeshta dhe punëve të ndërlikuara, pjesëmarrja e madhe e ekonomisë informale (37% e punëtorëve që u deklaruan si të punësuar, ligjërisht nuk janë të evidencuar), që çon deri tek evazoni i tatimeve. Me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendjeje në treg, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale hapi 30 zyra për punësim dhe 8 qendra për aftësimin profesional. Në vitin 2013 përmes këtyre zyrave dhe qendrave përkatëse u punësuan 4,729 persona të deklaruar si të papunë dhe 3,550 persona u aftësuan. Mirëpo, pas shpërthimit të krizës globale financiare, e cila u shndërrua në recesion global, ekonomia e lirë e tregut jo vetëm në Kosovë, por edhe në shumicën e vendeve të botës po kufizohet me forma

të ndryshme të proteksionizmit ekonomik. (Selman Selmanaj)

EKONOMIA E UJËRAVE. Përfshin pellgjet ujore si dhe përdorimin e tyre për të siguruar ujin për pije, për nevoja industriale dhe ujitje. Kosova ndahet në 4 pellgje ujore: Pellgu i Drinit të Bardhë (me kapacitet 60 m³/s), Pellgu i Ibrit (me kapacitet 33 m³/s), Pellgu i Moravës së Binçës (me kapacitet 7 m³/s) dhe Pellgu i Lepencit (me kapacitet 8 m³ /s.20). Lumenjtë kryesorë u takojnë kategorive të 2-ta dhe të 3-ta të ndotjes. Sipas legjislacionit në fuqi, ndërmarrjet publike që merren me administrimin e ujërave të pijes dhe ujërave për ujitje janë të klasifikuara në tri grupe: ndërmarrje publike qendrore, ndërmarrje publike rajonale dhe ndërmarrje publike lokale. Kosova bën pjesë në rajonet me sasi të limituara të resurseve ujore. Problemet e ujërave në vendet urbane janë: rrjeti i amortizuar, rrjedhjet e mëdha në rrjetin shpërndarës, keqpërdorimi i ujit dhe kyçjet ilegale. Në Kosovë nuk ekziston sistemi i duhur i mbrojtjes nga përmytjet. Një pjesë e sistemeve që janë ndërtuar më parë në shumë raste nuk mirëmbahen. Këto sisteme në Kosovë paraqiten si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore. Ekziston deficit i ujit, i cili ndikon në produktivitetin e fermerëve. Për të plotësuar nevojat për ujë të pijshëm, për ujitje, peshkim, turizëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike në shumë vende në Kosovë janë ndërtuar diga për grumbullimin e ujit të përrrenjve dhe lumenjve gjatë stinëve me prurje më të mëdha dhe për ta përdorur atë gjatë stinëve kur reshjet janë më të vogla. (Skënder Kaçiu)

EKONOMIA JOFORMALE. Tërësia e aktiviteteve ekonomike në krijimin e mallrave apo të shërbimeve, të cilat zhvillohen fshehurazi nga shteti dhe që nuk tatimohen nga qeveritë përkatëse. Për dallim nga aktivitetet formale, aktivitetet joformale nuk përfshihen në përlllogaritjet e brutoproduktit vendor apo në përlllogaritjet e brutoproduktit kombëtar (BPK). Në përdorim të përditshëm ekzistojnë edhe terma të tjerë për të përshkruar ekonominë joformale, si ekonomia e zezë, ekonomia nën hije apo ekonomia gri. Përveç aktiviteteve të ndaluara me ligj, ekonomia joformale përfshin edhe evazonin fiskal, punësimin joformal dhe deklarimin e pasaktë të pagave të punëtorëve.

Brenda ekonomisë joformale mund të dallohen dy lloj aktivitete: “të ligjshme” dhe “të paligjshme”. Përderisa të parat përfshijnë aktivitete që në rast të zbulimit mund të gjenerojnë të ardhura buxhetore shtesë për një vend, ato të paligjshmet përfshijnë aktivitetet ilegale që në rast të zbulimit nuk gjenerojnë të hyra shtesë, por pushojnë së ekzistuari. Nuk ka të dhëna për nivelin e ekonomisë joformale në Kosovë. (Lumir Abdixhiku)

EKONOMIA PYJORE. Veprimtari e rëndësishme ekonomike që merret me planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të fondit pyjor. Si një resurs i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës, pyjet janë një burim i rëndësishëm për mirëqenien ekonomike, sociale dhe mjedisore të Kosovës. Ato zënë rreth 40% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Përveç lëndës drusore, pyjet janë edhe burim i prodhimeve frutore, të bimëve të ndryshme mjekuese, sikundër që ofrojnë mundësi edhe për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme turistike, të gjuetisë etj. Sipërfaqet pyjore kanë rëndësi të madhe edhe për mjedisin, meqë një përqindje e madhe e biodiversitetit të Kosovës mbështetet pikërisht te pyjet. Rritja e pyllëzimit të tokës së braktisur bujqësore është një aktivitet i rëndësishëm, i cili mund të ulë vartësinë nga bujqësia dhe të përmirësojë kushtet e mjedisit në zonat rurale. Kjo ndikon pozitivisht në diversifikimin dhe qëndrueshmërinë e peizazheve. Vlera vjetore e prodhimeve dhe e përfitimeve të tjera nga pyjet dhe tokat pyjore sillen prej 50-75 milionë euro në vit. Potenciali i tanishëm kontribues i sektorit të pylltarisë në brutoprodhimin vendor sillet ndërmjet 1.8% deri në 2.6%, ndërsa me investimet përkatëse kjo përqindje mund të rritet deri në 3-4%. Rreth 50% e sipërfaqes së tërësishme pyjore në Kosovë shtrihet në lartësinë mbidetare më të ulët se 1,000 m, ndërsa shumica e sipërfaqeve (më shumë se 60 %) me drunj cilësorë shtrihen në lartësi mbidetare 600-1,000 m. Në këto sipërfaqe drunj të zakonshëm kanë rritje të mirë dhe kryesisht shfrytëzohen si burim i drurit teknik. (Skënder Kaçiu)

EKONOMITË FAMILJARE. Janë njësi statistikore-demografike me rëndësi sociologjike-ekonomike. Paraqesin bashkësi të personave, të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi ose banesë dhe që ushqehen bashkërisht. Numri, madhësia

mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare janë të kushtëzuara nga faktorët ekonomikë, socialë, demografikë etj. Për shkak të rrethanave të pavolitshme ekonomike-sociale, Kosova deri në fund të shekullit të kaluar kishte bashkësi familjare shumanëtarëshe, që njihen si familjet e mëdha. Këto familje ekzistojnë edhe sot e kësaj dite, ndonëse procesi i shthurjes të tyre është mjaft intensiv. Numri i ekonomive familjare në Kosovë ka shënuar rritje të vazhdueshme, krahas rritjes së numrit të përgjithshëm të popullsisë. Derisa në regjistrimin e vitit 1948 Kosova kishte 115,283 ekonomi familjare, në vitin 1961 kishte 152,598 dhe në vitin 1981 kishte 228,884 sosh. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në Kosovë është 297,090. Rritja e numrit të ekonomive familjare përcillet me zvogëlimin e numrit mesatar të anëtarëve. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit, një ekonomi familjare në Kosovë ka mesatarisht 5.9 anëtarë. (Hazer Dana)

EKSODI RURAL. Paraqet emigrimin intensiv të popullsisë nga vendbanimet rurale kryesisht në drejtim të qyteteve. Migrimet e popullsisë nga viset rurale janë të ndikuar nga një varg faktorësh, si pozita gjeografike dhe kushtet e pavolitshme, izolimi komunikues, faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë, demografikë, rrethanat historike-politike etj. Në Kosovë eksodi rural ka qenë mjaft intensiv, varësisht nga periudhat e ndryshme historike. Pozita gjeografike, relievi kodrinor-malor, prapambetja ekonomike, zhvillimet e ndryshme politike, dihotomia dhe pabarazia në zhvillimin e rajoneve, përqendrimi i funksioneve në vendbanimet urbane dhe mungesa e theksuar në ato rurale janë vetëm disa nga faktorët që kushtëzojnë migrimin e popullsisë rurale. Pasojat negative të këtij fenomeni tangojnë si hapësirat emigruese, ashtu edhe ato imigruese. Në hapësirat rurale vjen deri te regresi i përgjithshëm demografik, ndërsa në ato urbane rriten problemet infrastrukturore dhe urbanistike. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 në vendbanimet rurale në Kosovë jetojnë 1,078,239 banorë, apo rreth 62% e popullsisë së përgjithshme, ndërsa në vendbanimet urbane jetojnë 661,586 banorë, ose rreth 38%. (Hazer Dana)

EKSPEDITA E VUÇO PASHËS (1638). Një nga ekspeditat kryesore osmane kundër kryengritësve të Shqipërisë së Veriut në shek. XVII. U drejtua kundër krahinës së Malësisë së Madhe, popullsia e së cilës refuzonte të paguante detyrimet ndaj shtetit osman dhe herë pas here hidhej në kryengritje. Për ta nënshtruar një herë e mirë këtë krahinë, si dhe për të shmangur orvatjet për kryengritje edhe në vise të tjera shqiptare, sulltan Murati IV dërgoi kundër malësorëve forca të shumta ushtarake nën komandën e bejlerbeut të Bosnjës, Vuço Pashës. Në kushtet e një dimri të acartë, ushtria osmane depërtoi thellë në drejtim të Kelmendit, epiqendrës së kryengritjes. Sulmuesit planifikonin t'i kapnin banorët e zonës në shtëpitë e tyre dhe të bënin asgjësime masive, mirëpo planet e Vuço Pashës u morën vesh më parë nga malësorët. Ata lënë shtëpitë dhe, duke shfrytëzuar edhe borën e madhe, u pozicionuan në vende të mbrojtura. Pasi forcat osmane nuk i gjetën njerëzit në shtëpitë e tyre, u urdhëruan të kthehen mbrapsht. Gjatë kësaj tërheqjeje të dëshpëruar, kelmendasit sulmuan nga shpatet e maleve ushtrinë e Vuço Pashës, duke i shkakuar asaj një humbje të rëndë. Me këtë fitore malësorët arritën ta ruanin statusin e vetëqeverisjes që e gëzonin dhe më parë. Fitorja ndaj ushtrisë osmane pati edhe heronj të tillë, siç ishte Nora e Kelmendit, e cila sakrifikoi veten për të vrarë komandantin osman. (Ferit Duka)

EKSPEDITA OSMANE KUNDËR KELMENDIT (1700). Një nga operacionet ndëshkuese më të ashpra të autoriteteve osmane kundër popullsisë kryengritëse të Kelmendit. Gjatë viteve të luftës austro-osmane (1683-1699), kelmendasit u renditën në krah të aleancës kundërosmane të shteteve perëndimore (Venedikut dhe Austrisë). Me qëllim që të nënshtronin krahinën e pabindur dhe të frenonin prirjet e saj kryengritëse ndaj pushtetit osman, kreu i sanxhakut të Shkodrës, Hydaverdi Pashë Begolli u nis drejt Kelmendit në krye të një force ushtarake prej 6,000 vetash. Forcat osmane goditën vendqëndrimet e kryengritëse dhe rrethuan krahinën. Për shkak të rrethimit të zgjatur, një pjesë e banorëve pranuan kushtet e komandantit osman dhe u zotuan se hiqnin dorë nga kryengritja. Ata u lejua të qëndronin në vendbanimin e vet, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë, e cila nuk pranoi

t'i bindej pushtetarit osman u shpërngulën me forcë nga Kelmendi dhe u vendosën në vendin e quajtur Peshter në sanxhakun e Jeni Pazarit. Dy vjet më vonë, shumica e popullsisë së shpërngulur rezultoi e islamizuar. Me porosi të autoriteteve qendrore të Perandorisë, kelmendasit e kthyer në myslimanë u vendosën në toka të lira të sanxhaqeve të Prizrenit dhe të Vuçitërnës. Më 1707 pjesa më e madhe e kelmendasve katolikë të mbetur në Peshter u kthyen me forcë në vendlindje, duke çarë rrethimin osman. (Ferit Duka)

EKSPEDITA OSMANE KUNDËR MALËSISË SË MADHE (1612). Një nga operacionet më të mëdha ushtarake për shtypjen e qëndresës kundërosmane në Shqipëri. Pas kuvendeve shqiptare, atmosfera politike në krahinat veriore të vendit ishte mjaft e tendosur. Epiqendër e trazirave u bë zona e Malësisë së Madhe (krahina e Shkrelit, Kastratit, Hotit, Palabardhit, Kuçit etj.). Malësorët e kësaj ane u bashkuan në një aleancë politike të quajtur "Malet Shqiptare" dhe lidhën besën për mbrojtje të përbashkët të statusit të vetëqeverimit dhe për goditje të vendinstalimeve të ushtrisë osmane në territoret fqinje. Duke qenë se vala e kryengritjes së malësorëve po përhapej me shpejtësi edhe përtej krahinave të tyre, autoritetet osmane vendosën ta shtypin këtë lëvizje. Për këtë qëllim u organizua në Podgoricë një ushtri prej 25,000 vetësh, e cila marshoi drejt Malësisë së Madhe. Forcat osmane u përpoqën të depërtojnë në thellësi të trevës, por u ndeshën në një qëndresë të vendosur të kryengritësve, të cilët kishin bllokuar shtigjet e kalimit. Pasi dogjën e shkatërruan ku mundën, sulmuesit u shtrënguan të tërhiqeshin pa ia arritur qëllimit dhe me humbje njerëzore e materiale të konsiderueshme. Në këto rrethana, pas një viti, autoritet osmane ndërморën një tjetër operacion ushtarak me pjesëmarrjen e forcave të sanxhaqeve të Prizrenit, Dukagjinit, Shkodrës dhe Elbasanit. Shënjestra e operacionit ishte Kelmendi, vatër kryesore e qëndresës në Malësinë e Madhe. Pas luftimeve të gjata e të përgjakshme me kryengritësit kelmendas, ushtria osmane përsëri nuk mundi t'i mposhtë këta të fundit. Madje gjatë tërheqjes ajo u sulmua befasisht nga pozicionet e kryengritësve, duke pësuar humbje të rënda. (Ferit Duka)

EKSPORTI. Sasia apo vlera e të gjitha produkteve dhe shërbimeve të shitura jashtë vendit. Efektet e eksportit janë gjithëpërfshirëse, marrë këtu ndikimin që ka eksporti në normën e rritjes ekonomike, në punësim dhe në përmirësimin gjendjes së bilancit të pagesave. Sot pasqyra e eksportit në Kosovë është e karakterizuar me nuanca të theksuara, pasi ka një diferencë të konsiderueshme në eksportin e produkteve dhe atë të shërbimeve. Në total, sot eksporti i produkteve dhe i shërbimeve është përafërsisht 1 miliardë euro, apo rreth 20% e bruto prodhimit vendor. Tregjet kryesore për eksportuesit kosovarë janë vendet e rajonit dhe ato të Bashkimit Europian. Sektorët më aktivë në tregjet e jashtme janë produktet minerale dhe ato me bazë metalike, mirëpo edhe sektorët si transporti, turizmi, teknologjia informative etj. Performanca e eksportuesve në sektorin e shërbimeve ka qenë shumë më e mirë se sa ajo në sektorin e produkteve. Shërbimet kanë shënuar rritje të vazhdueshme në tregjet e jashtme, ndërsa vlera e tyre sot është mbi 600 milionë euro, përderisa eksporti i produkteve sillet rreth 300 milionë euro. Në terma relativë, kjo do të thotë se janë eksportuar dy herë më shumë shërbime nga Kosova sesa që janë importuar, ndërsa janë importuar rreth 10 herë më shumë produkte sesa që janë eksportuar. Marrë së bashku të dy sektorët, megjithatë situata në tregtinë e jashtme nuk është e favorshme për Kosovën, për shkak të bilancit të thellë negativ tregtar. Para së gjithash situata jo e favorshme në sektorin e tregtisë së jashtme është reflektim i nivelit të ulët të produktivitetit të industrive kosovare, që kanë rezultuar me nivel të ulët konkurrues të prodhimeve të tyre. (Petrit Gashi)

EKSPONIZITA “ARTISTËT E SË NESËRMES”.

Organizohet nga Galeria Kombëtare e Kosovës në bashkëpunim me Fondacionin për Shoqëri Civile nga Nju-Jorku. Çmimi për artistë të rinj të artit vizual është institucion i themeluar nga Wendy W. Luers, themeluese dhe drejtore e Fondacionit, e cila organizon vizitën studiuuese në SHBA, që i ndahet fituesit. Në programin e nisur në vitin 1991 në Çekosllovakinë e atëhershme, janë përfshirë edhe dhjetë shtete të Europës, që tradicionalisht vazhdojnë ndarjen e këtij çmimi. Këto vende janë të lidhura në një rrjet që mundëson bashkëpunim rajonal të artistëve të rinj. Në Kosovë programi u hap

në vitin 2002 dhe është konkursi i vetëm i këtij lloji, i cili i afirmon artistët e rinj dhe u jep mundësi të fitojnë një qëndrim gjashtëjavësh në Nju-Jork. Për brezin e ri të krijuesve kosovarë ky eveniment jo vetëm që ndikoi në masivizimin e pjesëmarrjes, por nxiti fantazinë dhe ndjeshmërinë për shtegtim drejt një arti të ri, bashkëkohor, që synon të ndikojë në rrjedhat e artit në Kosovë. (Iilir Muharremi)

EKSPONIZITA VJESHTORE E SHAFK-ut. Manifestim i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), i cili filloi me ekspozitën e parë, të organizuar në vitin 1973, në Galerinë e Arteve të Prishtinës. Që atëherë e deri në vitet '90 kjo ekspozitë ishte tradicionale. Zakonisht hapej në shenjë të festave të rëndësishme, që përkonin me muajt e vjeshtës. Spikasin ekspozitat e organizuara për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit. Organizimi i ekspozitave vjeshtore nuk u ndërpre as në vitet 1989-1999, por nga mjediset institucionale u bart në mjedise të tjera alternative, kryesisht në ambiente private hoteliere, siç ishin “Hani i 2 Robertëve”, kafe galeria “Koha”, “Evergrin”, “Europa” në Pejë etj. Vazhdimësinë e veprimtarisë së Shoqatës e dëshmon dhe ekspozita e 25-të jubilarë, tradicionale, Salloni i Nëntorit i Shoqatës së Artistëve Figurativë dhe Aplikativë të Kosovës, e cila u hap në shenjë të 28 Nëntorit. Që atëherë, në vijimësi, kjo ekspozitë do të bëhet tradicionale dhe do të funksionojë pandërprerje, gjithnjë duke u lidhur me këtë festë të rëndësishme kombëtare. (Hivzi Muharremi)

EKUILIBRI EKONOMIK. Gjendje në të cilën forcat ekonomike janë të balancuara (kërkesa e tregut është e barabartë me ofertën e tregut). Ekuilibri mund të jetë statik apo dinamik dhe mund të ekzistojë në një treg por edhe në tregje të shumëfishta. Ekuilibri mikroekonomik i referohet gjendjes kur sasia e kërkuar e një produkti është e barabartë me sasinë e ofruar të atij produkti, me çmim të caktuar dhe në kohë të caktuar. Kurse ekuilibri makroekonomik paraqet një gjendje kur kërkesa agregate (shuma e përgjithshme e mallrave dhe e shërbimeve përfundimtare që konsumatorët, firmat, qeveria dhe të huajt kërkojnë në një kohë të caktuar me çmime të ndryshme) është e barabartë me ofertën agregate (shuma e përgjithshme e mallrave dhe e shërbimeve që

ofrojnë prodhuesit në një kohë të caktuar me çmime të ndryshme). Në Kosovë, prodhimi vendor nuk ka arritur ta barazojë konsumin e përgjithshëm ndër vite, kurse oferta është ekuilibruar nga mallrat dhe shërbimet e importuara. Niveli i lartë i importit ka ndikuar gjithashtu që edhe çmimi në ekuilibër për produkte të ndryshme, por edhe inflacioni në nivel agregat, të ndikohen nga zhvillimet në tregjet prej nga importohen mallrat dhe shërbimet. Rritja e konsumit agregat dhe produkti i brendshëm bruto (PPB) në vend është mundësuar kryesisht nga të hyrat e larta financiare nga donacionet ndërkombëtare dhe remitancat, të cilat gjatë periudhës 2000-2013 mesatarisht kanë arritur normën e rreth 45% të PPB-së, me një rënie të shënuar pas vitit 2009 (mesatarisht në rreth 29% të PPB-së). Varësia e ekonomisë nga importi, mbështetur nga donacionet dhe remitancat, ka ndikuar që konsumi i përgjithshëm kombëtar (privat dhe publik) gjatë viteve 2010-2013 mesatarisht të jetë sa 108% e vlerës së PPB-së. Kësaj i ka kontribuar edhe pjesëmarrja e ulët e sektorit prodhues në PPB (mesatarisht rreth 11%). Edhe pse investimet e jashtme të drejtpërdrejta, të cilat që nga viti 2000 në mesatare kanë qenë më të larta se në shumicën e vendeve në zhvillim, vetëm rreth 15% e tyre janë investuar në sektorin prodhues. Në përgjithësi, zhvillimi i kapaciteteve prodhuese për produkte të reja konkurruese (oferta), si në tregun vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar mbetet sfidë kryesore e ekonomisë së vendit për të ekuilibruar konsumin e lartë (kërkesën), që viteve të fundit ka tejkaluar vlerën e PPB-së. (Fisnik Reçica)

ELBASANISHTJA. E folmja e qytetit të Elbasanit me tërë rrethinën e tij, që sipas ndarjes dialektore i takon gegërishtes jugore. Komisija Letrare Shqipe (1916-1918) kishte vendosur që ky variant të shërbente si bazë e gjuhës letrare për të gjithë shqiptarët. Gramatika e hartuar nga Xhuvani më 1919 ka shërbyer si gramatika kryesore e mësimin të shqipes në sistemin e arsimit në Shqipërinë Administrative deri me 1945, ndërsa deri me 1968 është shfrytëzuar në komunitetet shqiptare jashtë viseve shqiptare. Si më karakteristike në fushën e fonetikës mund të shënojmë disa specifika: realizimi i zanoreve hundore (zā:, hā:n, hū: etj.); gjatësinë e zanoreve, monoftongimin e diftongjeve dhe

të togjeve zanore (ue<u, ie<i, ye<y: grue<gru:, dielli<di:ll, krye<kry etj.); reduktimin e zanores ë të patheksuar, që zakonisht bëhet në mbarimin absolut të fjalës; mbylltoret qiellzore ruhen në ndonjë rast specifik edhe mund të afrohen me afrikatat. Në përgjithësi grupet e vjetra konsonantike *kl, gl* kanë përfunduar në mbylltore qiellzore: *qaj<klaj, gjuh(ë)<gluhë*. Grupet *mb, nd* kanë përfunduar në *m: mret<mbret, mush<mbush, maj<mbaj* dhe në *n: ven<vend, katun<katund, men<mend* etj.; kalimi i *h-së* në *f: shof<shoh, njof<njoh* etj. Si veçori më të rëndësishme të elbasanishtes në fushën e morfologjisë po përmendim: përdorimin e rasës vendore: në *p(ë)rrut, në krut* etj., trajtën e paskajores: *me punu, me ba, me shku* etj. E folmja e Elbasanit karakterizohet me shumicën e tipareve të gegërishtes jugore. (Imri Badallaj)

ELBI. (*Hordeum vulgare* L.) Është bimë një-vjeçare e familjes *Poaceae*, me $2n=14$ kromozome. Janë dy forma të elbit: vjeshtor dhe pranveror. Më herët në Kosovë janë kultivuar populacione vendore të elbit gjashtërendësh për prodhim të ushqimit për njerëz dhe kafshë. Më herët elb në Kosovë është mbjellë në sipërfaqe prej 14,000 ha, me rendiment mesatar deri në 1,020 kg/ha (1952/61). Pas ngritjes së Fabrikës së Birrës në Pejë shtohen sipërfaqet e mbjella me elb pranveror dyrrështor, në sipërfaqe 20,068 ha me rendiment mesatar 2, 202 kg/ha (1981). Më vonë sipërfaqet e mbjella me elb janë zvogëluar në 3,500 ha me rendiment mesatar 2,800 kg/ha (2004). Elbi vjeshtor gjashtërendësh (*Hordeum ssp. hexastichum*) përmban proteinë 14-18% dhe jep rendimente më të larta, që kryesisht përdoret si ushqim për njeriun, i kombinuar me drithëra të tjerë. Ky lloj elbi është komponentë kryesore përbërëse në ushqimet e koncentruar për kafshët. Kultivarët e elbit në Kosovë janë: Gotic (Francë), Helga dhe Toscana (Austri). Elbi pranveror dyrendësh (*Hordeum ssp. distichum*) është lënda e parë për përfitim të maltit në industrinë e birrës dhe alkoolit të distiluar. Kultivarët e elbit për birrë që aktualisht kultivohen në Kosovë janë: Rex (Kroaci) dhe Esterl (Francë). (Shukri Fetahu)

ELEFANTI I RAHOVECIT. Shtatore e elefantit e punuar në bronz. U zbulua në Rahovec (18 x 14.3 cm). Elefanti është paraqitur figurativisht në pozicion lëvizës, duke marshuar përpara, me shputat ngjitur në një pllakë altari. Elefanti

që marshon gjendet edhe në monedhat e perandorit romak, Anton Piu (138-161), të shtypura gjatë viteve 149-150. Është punuar në shek. I ose II dhe është inventarizuar në Muzeun e Kosovës. (Arianit Buçinca)

ELEKTROEKONOMIA. Kompani publike e Kosovës, e cila operonte me asetet prodhuese të energjisë elektrike dhe të mihjes së linjtit. Pos këtyre asetëve, në pronësi të saj ishte edhe industria kimike (prodhimi i plehrave kimike), gazifikimi (prodhimi i gazit nga thëngjilli), ter-torja (terja e thëngjillit), ndërmarrja për prodhim, riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve mekanike dhe elektrike, instituti për analiza dhe hulumtime dhe instituti i shëndetësisë. Kosova disponon potenciale të konsiderueshme energjetike të qymyrit dhe burime të tjera, duke përfshirë edhe një hidropotencial simbolik. Të gjitha këto njësi kanë funksionuar si të integruara deri në vitin 1999, ndërsa më pas janë ndarë si të pavarura nga korporata e Elektroekonomisë. Brenda Korporatës Energjetike deri në vitin 2006 kanë mbetur gjenerimi i energjisë, me njësitë e termocentraleve A dhe B, shpërndarja e energjisë elektrike, minierat dhe transmissioni. (Justina Shiroka-Pula)

ELEZAJ Isa (1953-). Biolog, profesor universitar. Lindi në Morinë të Gjakovës. Arsimimin bazë e mori në vendlindje dhe në Gjakovë, ndërsa studimet për biologji i kreu në



ISA ELEZAJ

Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës (1976). Studimet pasuniversitare, në fushën e shkencave biologjike i përfundoi në Universitetin e Zagrebit dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës në vitin 1989. Disa vjet punoi profesor në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë. Në vitin 1983 zgjidhet asistent në departamentin e biologjisë të FSHMN-së, ku më pas i arrin të gjitha gradat universitare. Ka qenë dekan i FSHMN-së. Është anëtar i Shoqatës së Fiziologëve Amerikanë. Ka publikuar shumë punime shkencore, abstrakte e kumtesa në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka realizuar vizita studimore dhe ka marrë pjesë

në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Fetah Halili)

ELEZI Abdulla (1959-). Profesor universitar. Lindi në Livoç të Poshtëm të Gjilanit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Gjilan, ndërsa u diplomua në Fakultetin e Kulturës Fizike në Sarajevë. Kreu studimet pasuniversitare në Zagreb, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (2005). Që nga vitit 2008 është mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sportit në Prishtinë, ku ligjeron lëndën e kineziologjisë dhe kineziterapisë. Botoi një varg punimesh shkencore në revistat brenda dhe jashtë vendit. Ndër të tjera, trajton fushën e ushtrimeve lëvizore dhe të ripërtëritjes sportive. (Xhavit Kajtazi)

ELEZI Lule (1970-). Pianiste. Lindi në Gjilan. Mësimet e para në piano i mori nga e ëma. Pasi përfundoi Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës në Prizren, kreu studimet në Fakultetin e Arteve në Prishtinë.



LULE ELEZI

Kreu specializimin dy-vjeçar në Akademinë e Arteve në Tiranë, magistraturën në Akademinë e Muzikës në Sarajevë. Luan si soliste, shoqëruese e pianiste ansamblesh. Ka mbajtur recitale në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Gjermani, Zvicër, SHBA, Austri, Suedi, Rusi etj. Veçohen: dy koncerte si soliste me Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit Shqiptar (Tiranë, 1994, 2001). Më pas performoi në Vjenë në Festivalin F. Shopenit (2009, 2010, 2011), ndërsa më 2010 ishte e vetmja nga Kosova që performoi me pianistë botërorë po në Vjenë. Më 2012, në Vjenë ishte pjesë e Ansambllit “Trio Celebre”. Ka realizuar recital në Kolegjin Mbretëror Muzikor në Stokholm, ku mbajti masterklasë (2011), pastaj një recital në Festivalin “F. Shopen” në Frankfurt (2011), dy në Wuhan (Kinë), (2012 dhe 2013); në San Petersburg, në Festivalin i Kulturave Kombëtare (2013); koncert recital në Hamburg (2012, 2014); më 2013, në Akademinë Muzikore Verore Europiane në Prishtinë ishte mentore dhe pianiste në Gala-koncertin e profesorëve. Më 2014 mbajti recital në Potsdam, Naumburg e Berlin, ndërsa më 2015 ishte

soliste me Filarmoninë e Kosovës. Po atë vit performoi mes pianistëve ndërkombëtarë në City Hall të Vjenës. Jeton në Prishtinë e Potsdam (Gjermani). Është profesoreshë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Arnisa Rexhepi)

ELEZI Xhevdet (1957-). Agronom, profesor universiteti, specialist i pedologjisë. Lindi në Blaç, komuna e Dragashit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen në Prizren, studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1980). Studimet pasuniversitare dhe disertacionin i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës (1998). Zgjidhet asistent dhe më vonë ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe më pas bëhet profesor për lëndët agrokimi dhe pedologji me bazat e gjeologjisë. Publikoi punime shkencore e profesionale, një tekst universitar ("Kimia e tokës") dhe mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore. Ka qenë prodekan dhe dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe të Veterinarisë të UP-së. (Bashkim Kabashi)

ELEZI-LEKËGJEKAJ Isë (1947-). Rapsod popullor, lahutar. Lindi në Koshutan të Rugovës. Ka në repertor rreth 10,000 vargje të eposit të kreshnikëve, prej të cilave rreth 6,500 vargje u incizuan në mars 1988. Këngët e tij i karakterizon rrëfimi i gjatë epik, legjendariteti, portretimi e heronjve, sidomos i Mujit e Halilit, përshkrimet poetike dhe figuracioni. Mori pjesë në javën e kulturës shqiptare në Paris më 2004 dhe në shumë festivale dhe u vlerësua me çmime dhe mirënjohje. Në koleksionin "Epika legjendare të Rugovës, këngë të kreshnikëve e balada" (15 vëllime) që ruhet në arkivin e Institutit Albanologjik të Prishtinës, është lahutari më i rëndësishëm i lindur pas Luftës së Dytë Botërore. Ka në repertor edhe balada dhe këngë epike historike. Jeton në Koshutan dhe në Pejë. (Zymer U. Neziri)

ELEZOVIQ Glisha (Gliša Elezović) (1879-1960). Filolog, historiograf, orientalist serb nga Kosova. Lindi në Vushtrri, ku e mbaroi shkollimin fillor. Shkollimin e mesëm e vazhdoi në Selanik dhe Stamboll. Studioi gjuhën serbe dhe sllavishten e vjetër në Beograd. U diplomua në vitin 1905 me temën "Tingujt e dialektit të Kosovë-Metohisë" (të serbishtes). Punoi edhe në Shkollën Teologjike

në Prizren. Ka dhënë ndihmesë në përkthimin dhe komentimin e dokumenteve të vjetra turke për Ballkanin Qendror. Është autor i "Fjalor i dialektit Kosovë-Metohisë I-II" (Reçnik kosovsko-metohiskog dijalekta I-II, Beograd, 1932, 1935). (Naile Mala-Imami)

ELMAZI Rexhep (1938-1978). Poet. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Shkrimet e tij të para i botoi në revistën "Zëri i rinisë", pastaj edhe në revistën letrare "Jeta e re". Një kohë punoi si përkthyes, ndërsa rregullisht merrej me krijimtari letrare. Për shkak të veprimtarisë politike, si themelues dhe anëtar i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, më 1964 u burgos nga regjimi i atëhershëm dhe u dënua me 9 vjet burg. Pas lirimit nga burgu, ndoqi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1972 botoi librin e parë poetik me titull "Frymëmarrje". U vra në rrethana të pasqaruara më 16 maj të vitit 1978. Pas vdekjes iu botua edhe përmbledhja me poezi "Fryma" (1994). (Agron Gashi)

ELSI Robert (Elsie) (1950-2017). Albanolog, përkthyes, shkrimtar nga Kanadaja. Studimet për gjuhësi dhe filologji klasike i kreu në Universitetin e Kolumbisë Britanike dhe studimet pasuniversitare i vazhdoi në Berlin, në Paris, në Dablin dhe Bon, ku e mbrojti doktoratën për gjuhësi krahasimtare dhe keltologji (1978). U specializua për albanologji. Në vitet '80 ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Bon dhe në vitet '90 ka qenë



ROBERT ELSI

përkthyes i shqipes në Bashkimin Europian, në Këshillin e Europës, në NATO dhe OKB. Prej vitit 2002 deri në 2013 punoi si interpret për Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës. Botoi një libër për historinë e letërsisë shqiptare (1995), fjalorin historik të Shqipërisë (2004) dhe të Kosovës (2004) në anglisht, fjalorin e religjionit, të mitologjisë dhe të folklorit shqiptar (2001) në anglisht dhe gjermanisht. Në bashkëpunim me J. Mathie-Heck ka përkthyer "Lahutën e Malcis" të Fishtës anglisht më 2005, ndërsa ka botuar në gjermanisht Kanunin e Lekë Dukagjinit. Më 1997 botoi antologjinë me shkrime për Kosovën "Kosova: Në zemër të fuçisë së barotit"

(Kosovo: In the Heart of the Powder Keg), dhe më pas përmbledhjen "Stuhi në horizont: Rrënjët e spastrimit etnik në Kosovë dhe Maqedoni, dokumente të fillimit të shekullit të njëzet" (Gathering Clouds: The Roots of Ethnic Cleansing in Kosovo and Macedonia, Early Twentieth-Century Documents). Publikoi dorëshkrimin e historisë së Shqipërisë të priftit francez Faverial. Në fushën e fotografisë, më 2007, botoi dy albume të mëdha. Kontributi i Elsit për promovimin ndërkombëtar të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare ka marrë dimension modern, përmes faqeve të tij të internetit, ku, përveç teksteve dhe dokumenteve të historisë shqiptare, gjenden regjistrime zanore të më shumë se 150 të folmeve të shqipes dhe zërat e disa figurave të njohura shqiptare të së kaluarës. Ky format elektronik ofron koleksionin më të madh të letërsisë shqiptare përkthyer në anglisht, si dhe koleksione të hershme fotografike nga Shqipëria dhe Kosova dhe prezantimin e artit pamor shqiptar. R. Elsi është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. (Lindita Tahiri)

ELSHANI Bislim (1955-). Gazetar. Lindi në Suharekë, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesmen, ndërsa u diplomua për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1981 u arrestua për aktivitet politik dhe u dënua me 7 vjet burg. Në vitet 1989-1993 i bashkohet alternativës politike shqiptare në Lubjanë. Punoi si redaktor në revistat dhe gazetat "Alternativa", "Republika" dhe "DeA", në të cilat botoi artikuj letrarë e eseistikë. Më 1994 emigroi në Zvicër, ku vazhdoi aktivitetin politik e publicistik në redaksinë e organit të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), "Zëri i Kosovës". Përgatiti botimin e librit "Filozofia politike e çështjes shqiptare" të Ukshin Hotit (1995). Në periudhën 1996-1998 u zgjodh kryeredaktor i gazetës "Zëri i Kosovës" (1996-1998). Punoi në Bazel të Zvicrës, në Universitetin Popullor Shqiptar dhe në vitet 2004-2006 në agjencinë informative shumëgjuhëshe "Sncweb", në të cilën është redaktor për gjuhën shqipe dhe serbokroate. Punoi edhe si përkthyes dhe lektor për gjuhën shqipe dhe serbokroate në administratën e Kuvendit të Kosovës (2012-2013). Jeton në Zvicër. (Muhamet Mavraj)

ELSHANI Gafurr (1958-). Gazetar, jurist. Lindi në Suharekë. Shkollën fillore dhe të mesme i

kreu në vendlindje, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës i lëvizjes studentore të vitit 1981, më pas anëtar i organizatës ilegale Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ), e cila ma vonë u bashkua me organizatat e tjera ilegale në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në korrik të vitit 1983 u burgos dhe u dënua për veprimtari armiqësore. Në vitin 1985 u arratis në Zvicër, ku veprroi deri në fillim të luftës, kur u kthye në Kosovë dhe iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në çlirimin e vendin. Bashkëpunoi me gazetën "Zëri i Kosovës", që botohej në Zvicër, ku shkroi artikuj dhe komente politike. Në vitin 1999 botoi librin "Ushtria Çlirimtare e Kosovës", që është një përmbledhje dokumentesh dhe artikujsh për veprimtarinë e UÇK-së në Kosovë. Pas fillimit të botimit të gazetës "Zëri i Kosovës" në Kosovës ushtroi detyrën e drejtorit të kësaj gazete. Së fundi ushtron profesionin e avokatit. (Artan Krasniqi)

ELSHANI Ymer (1948-1999). Shkrimtar dhe studiues i letërsisë për fëmijë. Lindi në Korroticë të Poshtme të Drenasit. Mbaroi shkollën fillore në vendlindje dhe në Komoran, ndërsa Shkollën Normale dhe Fakultetin për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë. Punoi si arsimtar, zëvendësdyrejtor e drejtor shkolle dhe këshilltar pedagogjik në shkollat e Drenasit. Shkroi poezi për fëmijë, por u shqua sidomos në tregimin dhe romanin për fëmijë. Në romane futi elementin fantastik. Personazhet e veprave të tij, si ato nga mikrobota, si ato nga jeta reale, u takojnë të gjitha meridianeve. U shqua edhe me studime dhe me shkrime kritike për letërsinë për fëmijë. Botoi njëmbëdhjetë vepra për fëmijë, ndërsa pas vdekjes iu botuan edhe një sërë veprash nga dorëshkrimet e fshehura gjatë luftës. Botoi veprat: "Anija e miqësisë" (1967), "Çka ëndërojnë lulet" (1971), "Loti udhëtar" (1972), "Isulli i lumturisë" (1973), "Guri i çmueshëm" (1977), "Unaza magjike" (1980), "Plaku me violinë" (1984), "Përrjetimet e Bardhoshit" (1989), "Ndodhitë e Hundëkarotës" (1971), "Aventura mbi trotinetin e vjetër" (1975), "Gjelastreni mendjelehtë" (2003) etj. Më 17 prill të vitit



YMER ELSHANI

1999, në fshatin Poklek të Drenasit Ymer Elshani u vra dhe u masakrua nga forcat serbe, bashkë me bashkëshorten, me të katër djemtë, me nënën, kumatën dhe me afro pesëdhjetë bashkëqytetarë të tjerë. Në shenjë nderimi për veprën e tij, në Drenas për çdo vit mbahet manifestimi letrar “Sofra poetike e Ymer Elshanit”, si dhe nga Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva” jepet çmimi letrar me emrin e tij për veprën më të mirë për fëmijë të botuar midis dy manifestimeve. (Xhevat Sylja)

ELSHANI Zymber (1950-). Shkrimtar për fëmijë, përkthyes letrar. Lindi në fshatin Korroticë të Poshtme të Drenasit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Komoran, shkollën e mesme teknike në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb. Punoi si mësimdhënës në shkollën e mesme teknike “28 Nëntori” në Prishtinë dhe në “Ferronikel” të Drenasit. Shkruan për fëmijë, poezi, tregime, pjesë teatrale dhe novela e romane. Personazhe të veprave të tij për fëmijë janë nga mikrobota, me efekte të dukshme personifikuese. Shprehjen e tij letrare e shquan një butësi, që i vjen shumë e afërt lexuesit të vogël. Merret dhe me përkthime letrare nga anglishtja. Veprat e botuara: “Lundërzat” (1970), “Buzëqeshjet e ngrohta” (1971), “Ëndërr me bisht” (1979), “Ylberi i brigjeve” (1981), “Meqë ra fjala” (2006), “Treni pa biletë” (2007), “Andrrallat e një fshati”, “Aventurat e Buburizës” (2002), “Kënga ngjan në zog të vogël” (2005) etj. (Xhevat Sylja)

EMERLLAHU Mehmet (1948-). Gazetar. Lindi në Ramjan të komunës së Vitisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe Pozharan, ndërsa shkollën normale në Ferizaj. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi në arsim, ndërsa profesionin e gazetarit e nisi në gazetën “Flaka e vëllazërimit” në Shkup, për të vazhduar më pas në gazetën “Rilindja”, në rubrikën e kulturës. Nga vitin 1991 ishte koordinator i botimit të jashtëm të “Rilindjes”, në Tiranë dhe Zvicër. Një pjesë të teksteve publicistike i përmbloodhi dhe i botoi në librat “Kosova flet vetë” (1989) dhe “Nyja e Kosovës” (2000). Ka botuar shkrime edhe në “Fjala”, “Zëri i rinisë”, “Shkëndija” etj. (Zenun Çelaj)

EMËRLLAHU Sadete (1950-2012). Poete. Lindi në fshatin Rahovicë të Preshevës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, gjimnazin në Preshevë dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Për afro katër dekada punoi si pedagoge e letërsisë në gjimnazin e Preshevës. Me krijimtari letrare u mor që nga bankat e shkollës së mesme, kur edhe botoi vjershën e parë në gazetën e studentëve “Bota e re” (1970). Shkroi poezi për të rritur dhe për fëmijë. Botoi veprat: “Dallgë zemrash” (1972), “Këngë të trazuara” (1995) dhe “Kërkoj kohë të qetë” (2009). Fati i femrës shqiptare ishte frymëzim i krijimtarisë së saj letrare. (Hasan Hasani)

EMIGRIMI EKONOMIK. Është zhvendosja e personave nga një vend në tjetrin, për mundësi më të mira punësimi ose për përmirësimin e nivelit të të ardhurave. Lëvizja e personave për këto qëllime bëhet kryesisht nga vendet me zhvillim më të ulët drejt vendeve me zhvillim më të lartë. Një studim i Bankës Botërore i vitit 2006 gjen se rreth 8 për qind e popullsisë së vendeve të zhvilluara përbëhet nga emigrantët, që kryesisht vijnë nga vendet në zhvillim. Emigrimi ekonomik ka tri efekte kryesore në ekonominë e vendeve të origjinës: së pari, zvogëlon fuqinë punëtore dhe në këtë mënyrë ul potencialin prodhues të vendit; së dyti, ndryshon përbërjen arsimore të fuqisë punëtore, pasi emigrantët zakonisht nuk përfaqësojnë punëtorin mesatar, por personat me aftësi më të lartë; dhe, së fundi, për shkak të uljes së numrit të popullsisë bie kërkesa agregate, duke krijuar kështu efekte multiplikuese sekondare dhe terciare në ekonominë e vendit.

Si rezultat i popullsisë së re, papunësisë së lartë për një kohë të gjatë dhe jostabilitetit politik gjatë viteve ‘80 dhe ‘90 të shekullit të kaluar, Kosova ka përjetuar valë të mëdha të emigrimit. Gjatë viteve të socializmit, duke filluar nga vitet ‘60, shumë punëtorë kanë emigruar përkohësisht në vendet e Europës Perëndimore, të cilat në atë kohë kishin mungesë të fuqisë punëtore. Në vitin 1981 vlerësohet se kishte rreth 27 mijë emigrantë kosovarë, edhe pse ky numër nuk është i saktë, pasi në atë kohë emigrantët nga Kosova nuk regjistroheshin si kosovarë. Gjatë viteve 1981-1987 këtyre iu bashkëngjitën edhe 50 mijë të tjerë. Numri u rrit ndjeshëm gjatë viteve ‘90 për shkak të përndjekjes nga regjimi

serb, largimit masiv nga puna të punëtorëve shqiptarë dhe kushteve të përkeqësuar ekonomike dhe politike. Pas vitit 1999 numri i emigrantëve kosovarë vlerësohet të jetë rreth 470 mijë, që i bie rreth 20 për qind e popullsisë së Kosovës. Vlerësime të ndryshme që janë bërë gjejnë se emigrantët kosovarë janë kryesisht të moshës së re, me moshë mesatare rreth 27 vjeç dhe rreth 60% e tyre janë të grupmshës 25-54- vjeçare. Rreth 60% e emigrantëve kosovarë të tanishëm kanë emigruar gjatë viteve '90. Studime të ndryshme tregojnë se sa i përket nivelit arsimor, emigrantët nuk përfaqësojnë rëndom një përzgjedhje të fuqisë punëtore. Ata janë mesatarisht më të arsimuar se personat që nuk kanë emigruara. (Avdullah Hoti)

EMINI Hyrë (1973-2001). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, dëshmore. Lindi në Ferizaj. Nisi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, më pas i vijoi në Fakultetin Histori-Filologji në Tiranë. Në vitin 1994 u dënua me 3 muaj burg. Pas liritimit nga burgu i vazhdoi studimet në Tiranë. Në qershor të vitit 1998 u kthye nga Shqipëria dhe u bashkua UÇK-së. U sistemua në Brigadën 161 të Zonës Operative të Nerodimes në Jezerc. Mori pjesë në aksione luftarake në betejën e Jezercit dhe të Reçakut. Gjatë luftës raportoi nga zonat e luftës për Radion "Kosova e lirë" dhe Agjencinë e Lajmeve "Kosovapress". Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës në Prishtinë. Me fillimin e luftës në Kosovën Lindore dhe Maqedoni i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc (UÇPMB) dhe më pas Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Ra dëshmore në një aksion ushtarak më 29 korrik 2001 në Tanushë të Gostivarit. (Ruzhdi Jashari)

EMINI Xhafer (1939-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Mitrovicë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Makinerisë në Universitetin e Beogradit (1965). Pas diplomimit zë punë në kombinatin "Trepça", në sektorin për investime në ndërtimin e fabrikës së akumulatorëve, ku më vonë bëhet drejtor i repartit, pastaj drejtor teknik dhe drejtor i Fabrikës së Akumulatorëve (1973). Udhëhoqi investimet në ndërtimin e Fabrikës së Baterive Industriale në Pejë dhe ishte zëvendës

i drejtorit gjeneral të kësaj fabrike. Në vitin 1982 kalon në Elektroekonominë e Kosovës në Prishtinë, ku kreu detyrën e drejtorit për investime të fabrikës së pajisjeve dhe pjesëve rezervë të xehetarisë në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Në vitin 1990 u emërua drejtor i përfaqësimit të "Trepçës" në Moskë. Ishte i angazhuar edhe në procesin mësimor në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, si bashkëpunëtor i jashtëm. Ndërkohë kreu studimet pasuniversitare në Zagreb dhe specializimet në Gjermani dhe SHBA. (Fehmi Krasniqi)

EMRA Bedri (1942-). Pikturor. Lindi në Gjakovë. Akademinë e Arteve Figurative, drejtimin e pikturës e kreu në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) që nga themelimi. Hapi një sërë ekspozitash personale: në Gjakovë në periudhën 1963-1999, pastaj në Prizren (1967), Beograd (1968), Katerini (Greqi, 1991), Grozhnjani (Slloveni, 1989) etj. Nga viti 1963, si anëtar i SHAFK-ut, është i pranishëm në shumë ekspozita kolektive, brenda dhe jashtë vendit. Piktura është vokacioni kryesor i krijimtarisë së tij. Njihet si peizazhist i motiveve të Çabratit. Veprat e tij u ekspozuan edhe jashtë vendit, përmes ekspozitave kolektive si në Poloni, Gjermani, Francë, Itali, Turqi, Egjipt etj. Mori çmimin për pikturë të Akademisë së Arteve në Prishtinë (1979), çmimin blerës të Sallonit të Tetorit në Beograd (1973), në Sallonin Pranveror të Kosovës (1976) dhe në ekspozitën "Portreti jugosllav" në Tuzell (1975), pastaj çmimin e parë të Bienales së Vizatimit në Prishtinë (1977) etj. Bëri vizita studimore në disa vende të Europës. (Hivzi Muharremi)

EMRA Tahir (1938). Pikturor, akademik. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve (1966) dhe studimet pasuniversitare në Beograd. Më 1967 u zgjodh ligjërues, pastaj profesor në Shkollën e Artit Pedagogjike në Prishtinë, ndërsa më 1974 mësimdhënës për vizatim dhe pikturë në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës.



TAHIR EMRA

Pas vitit 1991, me largimin e dhunshëm nga institucionet e arsimit, disa vjet mbajti mësim në atelienë e shtëpisë së tij, ndërsa pas çlirimit sërish vazhdoi në Fakultetin e Arteve, deri në pensionim më 2003. Mbajti lëndën e vizatimit dhe të pikturës edhe në Universitetin e Tetovës, në periudhën 1994-2004. Kreu detyra dhe funksione në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë dhe ishte anëtar i forumeve të ndryshme profesionale në institucionet dhe asociacionet e ish-Jugosllvisë. Është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Organizoi një sërë ekspozitash të mëvetësishme brenda dhe jashtë vendit si në Gjakovë (1959, 1960), Prishtinë (1963, 1968, 1979, 1988, 2003), Pançevë (1966), Beograd, Zagreb (1971), Mostar dhe Zenicë (1979), sërish në Beograd (1983), në Sarajevë (1989), si dhe ekspozitat retrospektive në Galerinë e Arteve në Tiranë (2005), në Prishtinë (2008), Gjakovë (2014) etj. Mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1966, pastaj në manifestime të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. I takon brezit të parë të krijuesve të artit pamor të Kosovës. Është piktor kolorist i peizazheve, enterierëve dhe natyrave të qeta. Në ciklet e para trajton motive kosovare, peizazhe, kompozime me tematikë sociale, të zbrërthyer në cikle, me shprehje ekspresive deri te abstraksioni gjeometrik. Veprat e tij gjenden në shumë galeri e muze, në institucione dhe koleksione private. Është fitues çmimesh dhe mirënjohjesh: Çmimi i Nëntorit i Prishtinës (1970), i mirënjohjes me diplomë në Bienalen "M. Barili" në Pozharevc (1972), i mirënjohjes në Bienalen e 13-të të Arteve Figurative në Aleksandri (1980), i Universitetit të Beogradit për pikturë (1964), çmimi special i Akademisë së Arteve në Beograd (1966), pastaj i Çmimit të Dhjetorit në Prishtinë (1972) dhe i disa çmimeve për vizatim dhe pikturë me rastin e ekspozitave të Shoqatës së Artistëve të Kosovës, të Serbisë dhe të Vojvodinës. (Hivzi Muharremi)

EMRA-SHAQIRI Latif (1893-1965). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa normalen turke në Shkup. Fillimisht shërbeu si mësues në Kolgecaj dhe në Tropojë. Në vitet 1915-1918 ishte mësues në shkollën shqipe në Gjakovës, si dhe në Izniq. Punën e mësimdhënies e vazhdoi

edhe gjatë viteve 1941-1944 dhe kontribuoi në ngritjen e arsimit shqip në Kosovë. Ishte mësues edhe pas Luftës së Dytë Botërore. (Jusuf Meqa)

EMRA-SHAQIRI Osman (1885-1926). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, ku mori edhe arsimin fillestar në gjuhën turke. Arsimin e vazhdoi në normalen turke në Shkup, ku mësoi edhe shkrim-lexim shqip. Në vitet 1915-1918 punoi si mësues në shkollën shqipe të Gjakovës. Në vitin 1923 hapi shkollën në Bujan, në vitin 1924 ishte mësues në Kolgecaj, përkatësisht në Krumë. Bashkë me Ali Kelmendin, më 1923, themeluan shoqërinë "Shkëlzeni" në Krumë, e cila e shtriu veprimtarinë e saj arsimore e politike në Kolgecaj, Krumë dhe në Malësinë e Gjakovës. O. Shqariri (Mano Shaqja, siç e quanin) u shqua për punën e mësuesit të përkushtuar. (Jusuf Meqa)

EMRULLAHU Dali (1938-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Breznicë të Bujanocit, ku kreu edhe shkollën fillore, gjimnazin e ulët e kreu në Muçivërcë të Kamenicës, Normalen në Prishtinë, ndërsa studimet për pedagogji i kreu në Fakultetin Filozofik në Shkup (1963). Doktoroi në pedagogji, më 1983, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punën arsimore e filloi si mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Shkollën Normale në Ferizaj, pastaj në Shkollën Normale në Prishtinë. Në vitin akademik 1968/69 u zgjodh mësimdhënës për lëndë pedagogjike në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Në vitin 1987 u zgjodh mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike, ndërsa në vitin 1997 mësimdhënës në Fakultetin e Mësuesisë në Prishtinë. Ndërkohë, ushtri edhe detyra të rëndësishme shoqërore dhe profesionale. Fusha e interesimit të tij shkencor është pedagogjia, sidomos ajo politeknike. Është autor studimesh profesionale-shkencore pedagogjike, të publikuara në revista e gazeta të ndryshme, si dhe i disa teksteve universitare dhe monografike: "Metodika e edukatës punuese e politeknike" (1975), "Praktikumi metodik për lëmin e edukimit punues" (1996), "Metodika e edukimit punues" (1997), "Bazat e metodikës së punës edukative" (1998), "Edukata estetike" (2001). (Januz Dervodeli)

ENTI I ENOLOGJISË. U themelua në vitin 2007 në Rahovec. Ky institucion merret me studimin e teknologjisë së prodhimit të

verës nga lënda e parë, përpunimin primar, fisnikërimin dhe finalizimin e produktit kryesor dhe të nënprodukteve. Në këtë institucion bëhen analizat e përmbajtjes së sheqerit në kultivarë të ndryshëm, caktohet momentit i vjeljes së rrushit dhe analizohet përmbajtja e alkoolit dhe e materieve të tjera përbërëse të verës. Enti ka laboratorin për kryerjen e të gjitha analizave enologjike dhe është i pajisur me certifikatë të ISO-së. Enti ka bërë digjitalizimin e të gjitha vreshtave në rajonet vreshtare të Kosovës. (Agim Zajmi)

ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE I KOSOVËS. Botues i teksteve shkollore për të gjitha nivelet e arsimit, i botimeve të veçanta dhe i mjeteve mësimore në Kosovë, me seli në Prishtinë, i themeluar në vitin 1970. Pararendës të tij ishin Drejtorati arsimuer për Kosmet, Drejtorati Arsimor për Kosovë e Metohi-Komisioni Pedagogjik, Shtëpia botuese (SHB) “Mustafa Bakija” (përkatesisht “Milladin Popoviq”, pastaj “Rilindja”) dhe Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë - Reparti Prishtinë. Gjatë periudhës 1970-1991, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore u mor me përgatitjen dhe botimin e teksteve mësimore të të gjitha niveleve të arsimit shqip, serbisht dhe turqisht në Kosovë dhe jashtë saj, me botimin e dokumentacionit pedagogjik e shkollor, të veprave të veçanta etj. Enti ishte i vetmi institucion për përgatitjen dhe botimin e teksteve mësimore dhe veprave shkencore nga fusha e arsimit. Kishte profesionistë dhe redaktorë tekstesh të fushave të ndryshme, për tekstet e shkollës fillore, për tekstet e shkencave të natyrës, të shkencave shoqërore e humanitare, për tekstet universitare, të arsimit të të rriturve, si dhe për botime të veçanta shkencore dhe letrare. Deri në vitet '70 të shek. XX, tekstet mësimore botoheshin në Beograd dhe përktheheshin në Prishtinë. Me themelimin e Entit krijohet mundësitë për angazhim shumë më të madh të autorëve kosovarë për hartimin e teksteve shkollore. Arriti të botojë tekste shkollore për të gjitha lëndët mësimore të shkollës fillore dhe të shkollave të mesme, si dhe një numër të konsiderueshëm tekstesh universitare. Në vitin 1991 në këtë institucion u vendosën masat e jashtëzakonshme dhe punonjësit shqiptarë u pezulluan nga puna. Disa prej tyre e vazhduan veprimtarinë botuese në lokale private. Veprimtarinë botuese Enti e rifilloi në

vitin shkollor 1992/93, ndërsa në vitin shkollor 1993/94 tekstet shkollor filluan të botohen me logon e tij. Në vitin 1998 Enti e ndërroi emrin dhe u quajt SHB “Libri shkollor”. Ky institucion, edhe pse në kushte të jashtëzakonshme, arriti të botojë ose të ribotojë shumë tituj tekstesh për shkolla të ndryshme. Në vitin 2005 SHB “Libri shkollor” u shndërrua në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila vazhdon me botimin e teksteve mësimore, krahas shtëpive të tjera botuese. (Bajram Shatri)

ENTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS. Institucion për punë instruktive-pedagogjike, i cili përmes këshilltarëve pedagogjikë u ndihmonte mësimdhënësve dhe shkollave në punën e tyre. U themelua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 1959. Kishte për detyrë të ndiqte funksionimin e sistemit të arsimit, të merrej me punë profesionale-analitike, me hartimin e udhëzimeve, të planeve dhe të programeve mësimore, të koordinonte punën e shërbimeve (enteve) pedagogjike komunale dhe ndërkomunale. Në vitin 1990 nga Enti Pedagogjik i Kosovës dhe entet pedagogjike rajonale autoritetet serbe përjashtuan të gjithë punonjësit shqiptarë. Në këto kushte, Enti e vazhdoi veprimtarinë e tij në lokale private. (Halim Hyseni)

EJNTREJ Gertruda (Gertruda Josifovna Ejntrej) (1929-2003). Albanologe ruse, profesoresh, përkthyesë. Lindi në Leningrad. Kreu studimet e larta për romanistikë po në Leningrad. U martua me kolegun e saj student Dhimitër Panda dhe shkoi në Tiranë. Aty mbajti mësimet e rusishtes dhe ligjëratat për letërsinë ruse dhe të huaj në Fakultetin Histori-Filologji të Institutit Pedagogjik (1955-1957). Punoi në Fakultetin e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe dhe në degën e gjuhës dhe të letërsisë ruse të Universitetit të Tiranës (1957-1959). Më 1959 u kthye në Leningrad dhe nisi të punojë në Universitetin e Leningradit. Ligjëroi lëndë të ndryshme nga fushat e gramatikës, historisë së letërsisë shqipe, leksikografisë dhe leksikologjisë, teorisë së përkthimit dhe stilistikës. Mbrojti disertacionin për krijimtarinë e Migjenit (1966). Botoi veprat: “Skicë të gramatikës së shqipes” (1982), “Doracak për teorinë e përkthimit” (me bashkautor Avni Xhelili, 1997), “Fan Noli dhe realizmi në letërsinë e Shqipërisë të shek. XX” (1999) dhe artikuj kushtuar letërsisë shqipe, problemeve të përkthimit dhe çështjeve të gjuhës. U mor me përkthimin e letërsisë shqipe

në gjuhën ruse. Përgatiti dy krerë për letërsinë shqipe në botim dyvëllimësh për historinë e letërsive të Europës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Më 1994 themeloi Shoqatën e Miqve të Shqipërisë në Shën Peterburg. U dekorua me urdhrin “Naim Frashëri” nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. (Marija Morozova)

EPIDEMITË MASIVE. Gjatë historisë, njerëzimin e kanë përcjellë epidemitë dhe pandemitë masive të sëmundjeve ngjitëse. Nga pasojat e tyre janë zhdukur qytetërime, kanë rënë perandori dhe janë zhdukur kombe. Epidemitë masive, si: murtaja, variola vera (lia), kolera, tifoja e morrit, lepra, malaria, ethet e verdha, TBC-ja, pandemitë e gripit, AIDS-i etj., kanë tronditur njerëzimin. Treva e Kosovës nuk bën përjashtim. Është e njohur epidemia e mortajës në antikitet, që kishte përfshirë gjithë Ilirinë. Ajo zgjati nga viti 435 deri në vitin 430 para e.s. Sëmundja u soll nga Etiopia në Greqi, pastaj në Iliri dhe përfundoi në Perandorinë Romake. Hipokrati e përmend epideminë e mortajës në Iliri. Një epidemi tjetër e mortajës përmendet në vitin 79 të epokës së re, pas erpursionit të Vezuvit ku kishin vdekur 2,000 deri 3,000 njerëz në ditë. Në vitin 166 deri në vitin 251 përhapet Murtaja e Kiprianit. Gjatë sundimit të Justinianit I kishte shpërthyer murtaja në Konstandinopojë (545), e njohur si vdekja e zezë (Murtaja e Justinianit ose murtaja e Prokop-it, i cili e përshkroi epideminë). Vdekshmëria ka qenë e jashtëzakonshme: në Konstandinopojë kanë vdekur deri 5,000 njerëz në ditë dhe supozohet se nga murtaja kishin vdekur më tepër se gjysma e popullsisë së Perandorisë Bizantine të asaj kohe. Kjo epidemi gjithashtu ka përfshirë vendet e Ilirisë, sidomos bregdetin Adriatik dhe pjesët verilindore (545-580). Epidemia u përhap në tërë Europën, duke e përgjysmuar popullsinë e asaj kohe. Dhjetë shekuj më vonë, në shek. XIV, në Europë kanë vdekur nga murtaja mbi 25 milionë njerëz. Prej “vdekjes së zezë”, siç quhej në atë kohë, u prek edhe Kosova. Nga murtaja, në Prizren vdiq gjenerali austriak Pikolomini dhe pak ditë më vonë vdiq në Prishtinë at Pjetër Bogdani (1689). Në vitin 1725 murtaja përfshiu edhe Pejën me rrethinë, me ç’rast vrau 2/3 e popullsisë. Në maj të vitit 1730, epidemia përfshiu Gjakovën dhe Nishin. Në vitin 1736 murtaja u shfaq në Shkodër, në Shqipërinë Veriore dhe në disa vise kufitare të

Malit të Zi. Njëra ndër epidemitë e mëdha të mesjetës në viset shqiptare është regjistruar në vitet 1770-1771, fillimisht në Shkodër, nga ku kaloi pastaj në Tivar. Në shtator të vitit 1781 epidemia u paraqit në Prishtinë. Në raportin e vicekonsullit të Raguzës, Andrea Doda të janarit të vitit 1782 thuhet se murtajën në një han të Prishtinës e solli tregtari turk nga Shkupi, i cili vdes dhe pas disa ditësh vdesin të gjithë personat që kishin qëlluar në atë bujtinë. Po me atë radhë Prishtina u përfshi nga një epidemi e paparë, me ç’rast vdesin mbi 20-50 persona brenda ditës. Banorët e Prishtinës ikin nëpër fshatra dhe e bartin me vete sëmundjen. Në Prishtinë mbesin rreth 90 familje fisnike, të cila u zhdukën nga sëmundja. Në Gjakovë sëmundja ishte paraqitur vetëm në tri familje. Në një dokument tjetër të Arkivit Shtetëror të Kotorrit, murtaja në vitin 1839 është paraqitur në Shqipëri, Kosovë e Sanxhak.

Në anën tjetër, epidemitë dhe pandemitë e lisë (variola vera) kanë vrarë shumë njerëz. Deri në vitin 1900 çdo i treti banor i botës ka vdekur nga kjo sëmundje, e cila nga viti 1976 u çrrënjos në shkallë botërore. Tifoja e morrit, sëmundje e luftërave dhe e varfërisë, gjithashtu ka vrarë me miliona njerëz. Lepra (gërbula) në shekujt XI-XIII, gjatë kryqëzatave, ka pasur karakter pandemie. Sëmundja ka qenë e përhapur edhe në viset tona dhe në këtë kohë janë hapur “leproziumet”, që zakonisht gjendeshin pranë manastireve në Shqipëri dhe Kosovë. Një prej tyre ka ekzistuar edhe në Deçan në shekullin XIV. Sipas vlerësimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), në vitin 1995 prevalenca në botë e sëmundjes së leprës ishte rreth 1.15 milion raste. Në Kosovë nuk është regjistruar asnjë rast prej Luftës së Dytë Botërore. (Isuf Dedushaj)

EPIGRAFIA E PERIUdhËS OSMANE. Nga periudha osmane në Kosovë ka mbetur një numër i konsiderueshëm i mbishkrimeve me alfabetin arab, të skalitura në objekte të ndryshme të arkitekturës monumentale, sakrale dhe profane, si në xhami, teqe, medrese, banja publike, kulla të sahatit, ura, kroje, hane e të tjera. Kanë mbetur gjithashtu mbishkrime në monumente mbivarrore, në vegla pune, në armë, sidomos në shpata dhe në enë të ndryshme. Monumentet epigrafike të kësaj periudhe në Kosovë janë të skalitura në materiale të forta dhe të qëndrueshme, si në gur, në dru, në metal etj.

Mbishkrimet janë kryesisht në vargje, në gjuhën arabe, osmane dhe perse. Në distikun e fundit të mbishkrimeve në vargje, përkatësisht në kronogram, gjendet pseudonimi poetik i autorit të mbishkrimit. Krejt në fund vjen gjysmëvargu izopsefik, i sajuar me fjalë, shkronjat e të cilave kanë vlerë numerike, kështu që për ta nxjerrë vitin e ndërtimit të objektit, përlllogaritet vlera numerike e tyre, sipas sistemit të llogaritjes ebxhedike. Epigrafia me alfabet arab në Kosovë ofron të dhëna burimore për kohën e ngritjes së këtyre monumenteve, për personat që i kanë ngritur ato, për personat që kanë përpiluar tekstet e këtyre mbishkrimeve, si dhe për rrethanat kulturore-historike të Kosovës gjatë periudhës osmane. Materiali epigrafik i kësaj periudhe është bazë empirike, mbi të cilën mund të nxirren përfundime shkencore për trashëgiminë kulturore të periudhës osmane. (Nehat Krasniqi)

EPIKA POPULLORE. Në traditën popullore ekziston si këngë historike ose si baladë. Krahas vjetërsisë dhe qëndrueshmërisë, ajo ka vlera poetike të rëndësishme. Krijimet më të hershme të epikës shqiptare janë këngët legjendare, të cilat e përbëjnë eposin heroik të kreshnikëve, Muajit dhe Halilit dhe çetës së tyre, ciklin e këngëve për Gjergj Elez Alinë, si edhe baladat e shumta legjendare. Duke filluar nga këngët për Betejën e Kosovës të vitit 1389, në epikën tonë popullore zë vend edhe kënga historike. Kjo këngë shënon fazën kalimtare ndërmjet këtyre dy llojeve të epikës. Epika historike përcjell me mjete poetike dhe muzikore të gjitha ngjarjet e rëndësishme që nga mesjeta e hershme e deri në kohën tonë. Mbledhja e poezisë epike shqiptare arrin tre shekuj, nga kënga e Pal Golemit, shënuar nga Nilo Katallano (1692). Është mbledhur një lëndë e shumtë e të gjitha llojeve të këngëve epike. Epika jonë vazhdon të kultivohet edhe sot e kësaj dite. U krijuan qindra këngë për dëshmorët e rënë në luftën e UÇK-së, të cilat, si krijime poetike dhe muzikore, tashmë janë bërë pjesë e kujtesës historike. (Zymer U. Neziri)

EPIROTA 1483. Shprehje shqip, e vënë në gojën e një personazhi të një komedie latinisht të Rilindjes italiane në stilin e Plautit të autorit Thoma Medius të vitit 1483 në Venedik. Këngëtari epirot me emrin Damaskin i drejtohet një hanxhiu me mallëkimin: *Dramburi te*

clofto gogle, që me të drejtë është interpretuar si Tramburë të kloftë gola, Tramburë të qoftë goja, T'u dridhtë goja. Dokumenti u botua nga Ludvig Braun dhe Martin Camaj më 1972. (Rexhep Ismajli)

EPOPEJA E JASHARËVE (1998). Rezistenca e armatosur e familjes Jashari të fshatit Prekaz të Drenicës, kundër forcave policore dhe ushtarake të Serbisë. Njihet edhe si Epopeja



KOMPLEKSI MEMORIAL "ADEM JASHARI"

e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Para se të ndërmerrej sulmi vendimtar, ndodhën tri rrethime të familjes Jashari nga ana policisë së Serbisë: më 30 dhjetor 1991, më 22 janar 1998 dhe më 5, 6 dhe 7 mars të po atij viti. Ndërkohë, Serbia kishte dënuar Adem Jasharin me 20 vjet burg në mungesë, bashkë me disa bashkëluftëtarë të tij. Pas daljes publike të UÇK-së më 28 nëntor 1997 në Llaushë të Drenicës dhe rritjes së hovshme të radhëve të saj, policia dhe ushtria e Serbisë ndërmori më 5 mars 1998 një operacion në shkallë të gjerë kundër UÇK-së, veçanërisht në zonën e Drenicës. Forcat ushtarake dhe policore serbe kishin zënë pozicionet nga Mitrovica deri në Skënderaj, përgjatë dy anëve të rrugës magjistrale. Sulmi i forcave serbe u ndërmor në drejtim të Prekazit të Ulët dhe të Epërm, të Polacit dhe të Llaushës. Qëllimi i tyre ishte depërtimi në Prekaz, ku ndodhej edhe vendkomanda e komandantit të UÇK-së, Adem Jasharit dhe e familjes së tij. Më 3 dhe 4 mars 1998, përreth Fabrikës së Municionit në Skënderaj ishin dislokuar forca të shumta serbe, përfshirë edhe artilerinë e rëndë. Po ashtu policia serbe kishte ngritur përforcime të shumta nëpër të gjitha postbllloqet e saj në Drenicë. Natën ndërmjet 5, 6 dhe më pas 7 marsit, Prekazi dhe lagjja

Jasharaj u rrethuan nga forcat e shumta serbe, përfshirë tanke, autoblanda dhe njësitë speciale të policisë. Më 5 mars 1998, rreth orës 5:00 të mëngjesit, forcat serbe ndërmorën një sulm të kombinuar mbi fshatrat Prekaz i Poshtëm, Llaushë, Polac, Marinë, Vojnik dhe Rakinice të komunës së Skënderajt, sulm që zgjati deri më 7 mars. Shënjestra kryesore e tyre ishte Familja e Shaban Jasharit në Prekaz të Poshtëm. Adem Jashari me të gjithë anëtarët e familjes, përfshirë edhe fëmijët dhe me luftëtarët e tjerë që ndodheshin në shtëpinë e tij, bënë qëndresë kundër forcave të mëdha. Kjo rezistencë bëri që lufta në lagjen Jasharaj të vazhdonte për tri ditë me radhë. Në të njëjtën kohë, forcat serbe vazhduan sulmin edhe ndaj fshatrave të tjera, ku ishin përqendruar njësitet e UÇK-së. Policia serbe, e cila kishte provuar t'i afrohej në këmbë lagjes Jasharaj, pësoi humbje të mëdha në njerëz. Pas kësaj filluan granatimet e kullës dhe të shtëpive përreth. Pas tri ditë rezistence, në betejë ra komandanti Adem Jashari, bashkë me familjarë të tjerë. Atë ditë u vranë 20 veta të familjes së ngushtë Jashari, ndër ta 4 gra dhe 8 fëmijë. Gjatë luftës treditore u vranë gjithsej 56 burra, gra, pleq e fëmijë. Gjatë këtij rrethimi dhe luftës me forcat serbe shpëtoi vetëm Besarta 11 vjeçe, e cila mbetet dëshmi e gjallë e kësaj lufte të madhe në Prekaz, që u bë vend i kthesës së madhe të historisë së popullit shqiptar të Kosovës. Kjo qëndresë u shndërrua në epopenë më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. (Sylë Ukshini)

EPOPEJA E JEZERCIT (26-29 shtator 1998). Formacionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Ferizaj dhe rrethinë e bënë daljen publike më 16 korrik 1998 në fshatin Jezerc. Po këtë ditë u zhvillua edhe beteja e parë në mes të forcave të UÇK-së dhe forcave ushtarake dhe policore serbe, te vendi i bashkimit të dy lumenjve. Dy ditë më vonë, më 18 korrik 1998, forcat e UÇK-së në fshatin Jezerc u pozicionuan në gjashtë pika kryesore. Komandant i UÇK-së në Jezerc u emërua Imri Ilazi. Kjo datë shënon edhe fillimin e luftës në komunën e Ferizajt. Luftimet më të mëdha u zhvilluan më 26, 27 dhe 28 shtator 1998. Në mëngjesin e 26 shtatorit 1998 forca të mëdha serbe, me armatim të rëndë ia mësynë Jezercit. Në luftën kundër forcave ushtarake serbe, që besohej se arrinin mbi 10,000 ushtarë, me tanke, helikopterë dhe armatime të rënda UÇK-ja qëndroi për tri ditë në vijën e

parë të frontit, në mbrojtje të pozicioneve të saj dhe të mijëra qytetarëve të kësaj ane. Gjatë kësaj lufte ranë 9 dëshmorë të UÇK-së dhe u plagosën rëndë disa të tjerë. Në planin ushtarak dhe politik, Epopeja e Jezercit ndodhi në një kohë, kur Serbia deklaronte se ishte thyer rezistenca e armatosur në Kosovë dhe se UÇK-ja ishte shpartalluar. (Ali Uka, Ruzhdi Jashari)

EPOSI I KRESHNIKËVE. Cikël këngësh epike legjendare, që konsiderohen ndër shtyllat më të rëndësishme artistike të kulturës shpirtërore të shqiptarëve. Është jehonë poetike shumështrësore e jetës së përbashkët, por edhe e konflikteve disashekullore ndëretnike e shqiptarëve me ardhësit sllavë në Ballkan që nga shek. VI-VII e deri në shekullin XIV. Këndohen nga rapsodët lahtarë, të cilët përveç këndimit tërheqës, janë mjeshtër të lahutës dhe të këngës popullore. Lahutarët dinë përmendsh edhe mbi dhjetë mijë vargje. Janë burra, por ka edhe gra lahtarë, si Ajshe Muriqi (Rugovë), Lumturie Nonaj (Lezhë) etj. Këngët e këtij eposi janë kënduar në dasma, gazmende, në festa dhe në raste të tjera, si dhe në mbrëmje, gjatë stinës së dimrit. I këndojnë pjesëtarët e të dy besimeve si myslimanët, ashtu edhe të krishterët. Përcjellja bëhet me lahutë ose me çifteli, apo sharki. Lahuta është e ngritur edhe në shkallë kulti dhe në zbulimin e saj vend qendror zënë figurat-totem dhia e egër dhe gjarpri. Zonat kryesore të eposit legjendar në viset shqiptare të Veriut janë: Malësia e Madhe (Koja, Triepshi, Gruda, Hoti, Kelmendi, Shkreli, Kastrati), Shala e Shoshi, Nikajt e Mërturi, Malësia e Gjakovës (Gashi, Krasniqja, Bytyçi), Plava e Gucia, Rugova, Peshteri, Lezha, Kurbini. Me interes është edhe shtrirja e eposit në zonat e tjera, nga Puka, Hasi, Rrafshi i Dukagjinit, Llapusha, Shala e Bajgorës, Rrafshi i Kosovës, Llapi, Gallapi, Karadaku e deri në Luginën e Vardarit e në fushëgropën e Kërçovës. Legjendariteti është veçori kryesore e këtyre këngëve. Qeniet mitike, sidomos Ora e Zana, qëndrojnë në themelet e tij. Mbizotëron fantastikja, rrëfimi i gjatë epik, hiperbolizimi, figuracioni i pasur poetik, formulat, përshkrimet e dyluftimeve, portretet e kreshnikëve, tiparet etike e morale, kodi i nderit, sintaksa e vargut, pushimet muzikore etj. Temat janë të shumta, e më kryesoret janë: mbrojtja e territorit me pyje-kulloza, mbrojtja e bagëtisë, e kullës dhe e familjes (nëna, nusja, motra). Është e pranishme edhe tema e luftës kundër taksave, e origjinës

së kreshnikëve dhe e martesës: me miqësi, me kusht, me rrëmbim, me dhunë; tema e zënies rob, e rivalitetit: xhelozia, smira, inati etj. E pranishme është edhe tema e hakmarrjes, e tradhtisë së gruas, si dhe tema e dhunimit të varreve nga kundërshtarët etj. Dallohen këngët kreshnike të koleksionit të A. Lordit (i viteve '30 të shek. XX), i "Visareve të kombit" (blejtë I e II, 1937 dhe IV, 1939), të përmbledhjes "Zana popullore" (K. Taipi), të "Hyllit të Dritës", "Leka", "Edukata e re" etj. Brezi i viteve '20-'30 është pararendës i mbledhësve dhe botuesve të eposit në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, si: Z. Sako, Q. Haxhihasani, Gj. Komnino, A. Çetta, D. Shala etj. Deri më 2014 janë mbledhur rreth 600,000 vargje. Për aspekte artistike të këtij lloji të poezisë epike janë shkruar studime të shumta nga studiues shqiptarë dhe të huaj, janë mbrojtur disertacione doktoratash nga viti 1937 e këndeje, janë organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare etj. Duke qenë monument i lashtë etnokulturor, për eposin e kreshnikëve është përgatitur dosja për t'u vendosur në mbrojtje të UNESCO-s, si vlerë e trashëgimisë botërore të njerëzimit. (Zymer U. Neziri)

EREBERA Jashar (1872-1953). Rilindës, veprimtar i arsimit, publicist. Lindi në Dibër, ku mori edhe mësimet e para. Vijoi arsimin në ruzhdien turke në Dibër, në Manastir dhe



JASHAR EREBERA

në Shkollën Normale "Drita" të Bukureshtit. Bashkë me Dervish Himën nxorën fletoren "Indipendenta Albanie" (Pavarësia e Shqipërisë), me moton "Shqipëria Shqiptarëve". Në kuadër të shoqërisë "Drita" kontribuoi për botimin dhe shpërndarjen e librave shqipe ndër shqiptarët. Në vitet 1902-1905 në Beograd nxori gazetën "Albanija", ndërsa në vitet 1911-1912 në Shkup nxori gazetën "Shkupi", nëpërmjet të cilave afirmonte çështjen shqiptare. Gjithashtu, ai themeloi klubin shqiptar në Kumanovë (1909), hapi një shkollë nate në këtë qytet dhe një tjetër në Rekë të Epërme. Gjatë viteve 1924-1939 ishte deputet në parlamentin shqiptar, mori pjesë në komitetet revolucionare në Ballkan, me synim bashkimin kombëtar dhe mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare. (Sabit Jaha)

ERENIKU. Lumë në pjesën perëndimore të Kosovës. Buron nga liqeni akullnajor i Gjeravicës, në rrëzë të majës me të njëjtin emër me lartësi 2,656 m, që është maja më e lartë në Kosovë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës arrin 515 km², gjatësia 51 km, prurja mesatare vjetore 12-14m³/sek. Prej burimit deri në fshatin Junik ka tipare të lumit malor, ndërsa prej Junikut kalon nëpër rrafshinën lumore me rëndësi ekonomike dhe antropogjeografike me dendësi banimi që nga koha parahistorike. Me degët e veta Gusha e Batushës, Restusha, Vogovica në të djathtë dhe lumenjtë Krena dhe Trakaniqi në të majtë, Ereniku formon një sistem të veçantë lumor, përplot tarraca lumore dhe liqenore, që shënojnë faza të caktuara të tërheqjes së liqenit të dikurshëm dhe formimin e luginave lumore. Në luginën e Erenikut sedimentet e periudhës së kuartarit në sasi të mëdha përfaqësohen me rërë, zhavorr, konglomerate dhe me depozitime aluviale. Deri në derdhje në Drinin e Bardhë, në fshatin Gegjë, ku fillon kanioni i njohur i Gradishës, Ereniku ujit fushën e Gjakovës me rrethinë në perëndim dhe jugperëndim. Gjatë rrjedhës kalon nëpër disa ura, ndër më të njohurat janë Ura e Tabakëve dhe Ura e Terzive. Kjo luginë me fund të sheshtë, me ujëndarës midis luginave, me tarraca lumore dhe me sedimente liqenore, është ndër më pjellorët për bujqësi, pemëtare dhe prodhime bulmetore. Ereniku me degët e veta në pranverë të vonshme dhe në verë gati shteron, ndërsa në vjeshtë dhe në fillim të pranverës del nga shtrati dhe përmbyt tokat përreth. (Nesim Vala)

EROZIONI. Procese të shkatërrimit natyror të shkëmbinjve të kores së Tokës, si rezultat i veprimit të faktorëve të jashtëm atmosferikë (rrezatimi diellor, ndryshimi i temperaturave, reshjet atmosferike, era), rrjedhat ujore, akullnajat etj. Erozioni mund të shpejtohet nën ndikimin e aktivitetit të njeriut, si rezultat i shpyllëzimit dhe i përdorimit të pakontrolluar dhe jo të drejtë të tokës. Rezultatet e erozionit konsistojnë në shkatërrimin e shkëmbinjve, në transportimin e materialeve dhe grumbullimin e tij. Rezultat i kësaj veprimtarie është krijimi i formave të ndryshme të relievit (forma të jashtme-ekzogjene). Për nga faktori veprues, dallohen erozioni fluvial (lumor), glacial (akullnajor), abraziv (oqeanet, detet, liqenet), eolik (erërat) etj. Aktiviteti përfundimtar i

forcave të jashtme erozive është sheshimi i sipërfaqes së tokës, duke i rrafshuar pjesët e ngritura dhe duke i mbushur thellimet, të cilat janë formuar nga forcat e brendshme. Erozioni në Kosovë është i zhvilluar në terrenet e ndërtuara nga sedimentet flishore, tufet vullkanike dhe sedimentet argjilore në vendet me relief të pjerrët. Në Kosovë rreth 6,000 km² ose 56% të tokës i nënshtrohet erozionit të fuqishëm deri mesatar (rrethina e Mitrovicës, rrëzat e Bjeshkëve të Nemuna dhe Moknës, juglindja e Gollakut, disa pjesë të Malit të Sharrit etj.). (Shpejtim Bulliqi)

ERSOJ Mehmet Akif (1873-1936). Poet, shkri-mtar, akademik, autor i himnit kombëtar turk. Lindi në Stamboll. Ishte me origjinë shqiptare. Rrjedh nga familja Mulaj nga Shushica e Istogut në rajonin e Pejës, e cila u shpërngul për në Stamboll rreth vitit 1850. U mor që herët me letërsi, pavarësisht se studimet i ndoqi për veterinari. U diplomua në Mülkiye Baytar Mektebi (Shkolla Veterinare), në vitin 1893. M. Ersoj dha një kontribut të rëndësishëm në luftën për shpalljen e Republikës Turke. Mbeti personalitet i rëndësishëm në historinë e Republikës së Turqisë, duke shkruar himnin kombëtar turk. Në seancën e 12 marsit 1921, Asambleja Kombëtare Turke caktoi zyrtarisht poezinë e tij tekst të himnit kombëtar. U mor edhe me histori dhe letërsi. M. Ersoy u transferua në Kajro në vitin 1925 ku jepte gjuhën turke në një universitet. Aty qëndroi 11 vjet. Gjatë një vizite në Liban u sëmur nga malaria. Vdiq në Turqi dhe u varros në varrezat e martirëve në Stamboll. Ishte personi i parë në historinë e Republikës së Turqisë që në ceremoninë e varrimit iu intonua himni kombëtar. (Frashër Demaj)

ESNAFET. Bazat e organizimit korporativ të zejeve në Kosovë gjenden në Prizren që në shek. XIV. Ndërkaq, me fillimin e sundimit osman në shek. XV, tregtarët dhe zejtarët përfshihen në organizata esnafore, të cilat njihen edhe nga organet e pushtetit osman. Por sistemi esnafor përgjithësisht në Ballkan, pra edhe në Kosovë, njihet që nga shek. XVI, merr hov në shek. XVII, dhe arrin kulmin në shek. XVIII. Esnafet vazhdojnë jetën e tyre edhe në shek. XIX, por nga gjysma e dytë e këtij shekulli roli i esnafeve bie vazhdimisht. Ndryshimi i forcave prodhuese, ndryshimi i tregut dhe i

jetës ekonomike përgjithësisht, bëri që në fillim të shek. XX esnafet të përjetojnë rënie deri në zhdukje.

Në organizatat esnafore (gildat), zejtarët bashkoheshin sipas profesioneve, ndërsa qëllimi i tyre ishte mbrojtja e interesave të përbashkëta. Burimet historike dëshmojnë se në Kosovë esnafet më të zhvilluara i kishte Prizreni (që nga shek. XVI). Së pari njihej esnafi i tabakëve (lëkurëpunuesve), pastaj esnafi i demirxhinjve (farkëtarëve), ai i saraçëve (lëkurëpunues) dhe esnafi i terzinjve (rrobaqepësve). Po në Prizren, më vonë ka lajme edhe për esnafin e mutafxhinjve (prodhues torbash), atë të tyfekxhinjve (armëtarëve), të briskaxhinjve (thikëpunuesve) dhe atë të kujunxhinjve (argjendarëve). Esnafi i tyfekxhinjve në Prizren ishte organizatë që punonte e pavarur. Në Gjakovë dihet për esnafin e tabakëve (lëkurëregjës), pastaj për esnafin e tyfekxhinjve dhe të terzinjve, që vepronin si një organizatë e përbashkët. Gjithashtu dihet edhe për esnafin e abaxhinjve (zhgunëpunues). Thuhet se esnafi i terzinjve ishte ndër më të pasurit. Në Pejë ishin të bashkuar esnafi i tyfekxhinjve me atë të tabakëve, ndërsa esnafi i kujunxhinjve punonte si i pavarur. Për Prishtinën ishte i njohur esnafi i mutafxhinjve, në kuadër të të cilit vepronte edhe esnafi i hasraxhinjve, si dhe esnafi i kazanxhinj-kallajxhinjve. Tubimi apo grupimi i zejtarëve, i punëtorive (dyqaneve) të një dege dhe të një profesioni mundësonte krijimin e rrugëve apo të lagjeve me emërtimin e zejeve apo mjeshtërive përkatëse. Nga shumë lagje zeytare, rrugë ose sokakë, më të njohurat ishin ato të kujunxhinjve, demirxhinjve (farkëtarëve), nallexhinjve, tabakëve dhe terzinjve. Lagje të këtilla kishte në çdo qytet ku vepronin zejtarët.

Organizatrat esnafore kishin udhëheqjen e vet me hierarki dhe mekanizma të nevojshëm për veprim. Organi më i lartë ishte këshilli i esnafit, ndërkaq vendi ku këshilli takohej për kuvendim quhej lonxha. Edhe brenda një zejeje, po ashtu, kishte hierarki të rregulluar, që reflektonte shkallën e shfrytëzimit të atij që mësonte zejen, derisa ta arrinte titullin e mjeshtrit të pavarur. Përveç funksionit të vet bazë, atë prodhues-ekonomik, esnafet kryenin edhe funksione të tjera: funksion shoqëror, politik dhe ushtarak, arsimor dhe fetar. Esnafet në Kosovë kishin ndikim të madh në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik. Duke

pasur forcë ekonomike, duke ndërtuar tregje, ura, kroje dhe objekte publike për veprimtari ekonomike e shoqërore, duke u interesuar për hapjen e shkollave, esnafet e qyteteve përkatëse pasuronin edhe jetën urbane. (Drita Halimi-Statovci)

ETEMAJ Burim (1978-). Gazetar. Lindi në Saradran të Istogut, ku mori edhe mësimin fillor e të mesëm. Kreu studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Me gazetari nisi të merrej në gazetën e studentëve “Bota e re” e më pas (2001-2003) punoi në gazetën “Epoka e re”. Ishte kryeredaktor i gazetës “Epoka e re” dhe anëtar i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Nga viti 2014 u angazhua në mësimdhënie në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në departamentin e gazetarisë. (Muhamet Mavraj)

ETEMI Afrim (1951-). Piktur konservator-restaurues. Lindi në Pejë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë. U diplomua në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura në Bruksel të Belgjikës. Studimet pasuniversitare nga fusha e konservimit dhe e restaurimit të pikturës murale i mbaroi në Universitetin e Lubjanës. Pas studimeve u punësua në Entin Krahinor për Mbrojtje të Monumenteve të Kulturës në Prishtinë, në sektorin e konservim-restaurimit. Këtu fitoi gradat dhe titujt profesionalë për konservim-restaurim të pikturës murale e dekorative. Realizoi një sërë projektesh për restaurimin e freskave mesjetare të stilit bizantin dhe të arabeskave islame në monumentet e Kosovës. Ndër të tjera, punoi në Kishën e Shën Nikollës në Patrikanën e Pejës, në Kishën e Shën Arkangelëve në Nerodime, në Manastirin e Graçanicës etj. Po ashtu restauroi arabeskat në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë, në Xhaminë e Sinan Pashës në Prizren, në Xhaminë e Madhe në Prishtinë etj. Është edhe studiues i fushës së pikturës. Hapi disa ekspozita të pavarura dhe mori pjesë në ekspozita grupore në pikturë, grafikë, mbrojtje të trashëgimisë etj. (Fejz Drançolli)

ETEMI Muzafer (1969-). Aktor. Lindi në Sellcë të Tetovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje dhe në Tetovë. Studimet për aktrim i kreu në vitin 2000 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Luajti

kryesisht në Teatrin e Tetovës, por edhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin Shqiptar të Shkupit dhe në disa teatro të tjera. Disa nga shfaqjet, në të cilat luajti në role të ndryshme: “Të vdekur të pavarrosur”, “Trëndafili tatuazh”, “Makbethi”, “Maturantët”, “Lavrja e denjë për respekt”, “Shi në plazh”, “Policët”, “Audienca”, “Emigrantët”, “Shtëpia në kufi”, “Syri i ligë”, “Shtëpi në erë”, “Hamleti në teatrin tonë”, “Dashuri, teatër dhe marrëzi të tjera” etj. Luajti edhe në filmat artistikë “Lufta mbaroi”, “Koha e kometës”, “Kthimi”, si dhe në disa filma të metrazhit të shkurtër dhe në serialet televizive: “Mr. Alfabeti”, “Hoteli i Mihanes” etj. Gjatë viteve 2004-2005 punoi si asistent i lëndës së aktrimit në Fakultetin e Arteve të Universitetin e Tetovës. Nga viti 2007 është anëtar i ansambllit në Teatrin e Tetovës. (Kushtrim Bekteshi)

ETIKA TRADICIONALE. Një sërë rregullash apo normash, të cilat rregullojnë sjelljet e pjesëtarëve të bashkësisë shoqërore. Etika tradicionale bazohet në doke e zakone, përkatësisht në traditë. Ky tip i etikës praktikisht barazohet në zakone dhe lidhet me shoqëri patriarkale, të cilat në Kosovë ende mund të gjenden në mjedise rurale. Në këto shoqëri denjësisht respektohet tradita, kështu që i zoti i shtëpisë është personi që e ka fjalën kryesore. Tradita, po ashtu, kërkonte edhe njëfarë lloj hierarkie në shtëpi, kështu që më së shumti vlerësohet lindja e djalit të parë, pastaj lindja e vëllezërve të tjerë dhe së fundi e motrave. Tradita vlerësohe se farefisnia sipas “vijës mashkullore” është më e rëndësishme se ajo sipas “vijës femërore”. Në jetën bashkëkohore etika tradicionale nuk e ka më atë ndikim që kishte dikur. Ritmet e shpejta të urbanizimit, të industrializimit dhe të teknologjisë informative ushtrojnë ndikim në organizimin e jetës në komunitet dhe bashkë me këtë, edhe në respektimin e vlerave të etikës tradicionale. (Bashkim Lajçi)

ETNOGRAFIA. Shkencë shoqërore që hulumton mënyrën e jetës së popujve dhe trashëgiminë e tyre materiale, shoqërore dhe shpirtërore, si shprehje të identitetit të tyre. Trashëgimia etnografike e Kosovës është e pasur dhe e shumëllojshme. Të gjitha trevat e Kosovës kanë karakteristika të veçanta etnografike, por disa syresh i kanë ruajtur ato më



VESHJE POPULLORE

gjatë se të tjerat. Veçohen trevat e Rrafshit të Dukagjinit, të Rugovës, të Hasit të Prizrenit, të Drenicës etj., ku trashëgimia etnografike nuk ka pësuar shumë ndryshime dhe ndikime të kulturave të huaja. Në Kosovë popullsia e fshatrave merrej kryesisht me bujqësi, blegtori dhe aty-këtu me ndonjë zeje, ndërsa në qytete kryesisht me zejтари dhe tregti. Vendbanimet janë të tipit të grumbulluar në zona urbane dhe të tipit të grumbulluar apo të shpërndarë në zona rurale. Banorët e Kosovës jetonin në shtëpi të tipit me hajat, me çardak dhe qoshk. Kullat ishin të përhapura sidomos në fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit, të Drenicës, të Malishevës, të Hasit të Prizrenit, të Suharekës, por edhe në Pejë, Deçan, Gjakovë, Rahovec etj. Pos funksionit për banim, shtëpitë dhe kullat kishin funksion edhe të mbrojtjes familjare, shoqërore dhe kombëtare. Në jetën shpirtërore banorët e Kosovës u mbeten besnikë dokeve, traditave, riteve dhe besimeve të lashta vendëse, me anë të së cilave e rregullonin jetën familjare dhe shoqërore, punët dhe veprimtaritë e përditshme, jetën fetare, dokesore, juridike etj. Kjo popullsi në disa vise deri vonë ruajti mënyrën tradicionale të jetesës, të ushqimit, përfshirë mjetet e punës, enët e amvisërisë etj. Mjekësia popullore në Kosovë në të kaluarën praktikohet me përdorimin e bimëve dhe barnave natyrore si dhe me kryerjen e veprimeve magjike për parandalimin apo mjekimin e sëmundjeve të ndryshme. Populli besonte në magji dhe në syrin e keq, si dhe në aftësitë çudibërëse të vendeve të shenjta. Ruante gjithashtu mjaft besime popullore, disa syresh pagane animistike, besimin në trupa qiellorë, në kultin e gjarprit dhe të shqiponjës. Deri vonë mbijetoi edhe besimi në figura mitologjike dhe në rite të motmotit. Arti popullore i Kosovës ishte i zhvilluar

sidomos në punimin e metaleve, të lëkurës, drurit, gurit, tekstilit, baltës dhe të stolive. Në të kaluarën veshjet popullore të Kosovës ishin të shumta dhe të larmishme. Veshjet popullore të meshkujve ishin unike dhe me më pak dallime, ndërkaq veshjet popullore të femrave kishin kolorit të pasur dhe dallonin nga një rajon në tjetrin. Kosova përmendej për zejet e armëpunuesve, argjendarëve, qeleshepunuesve, tabakëve, terzinjve, saraçëve etj. Traditat etnomuzikologjike prezantohen nga ansamblet folklorike të Kosovës nëpër festivale të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj. Lojërat popullore janë praktikuar kudo në Kosovë. Më të përmendurat janë ato të kapuçave, gurapeshi, vrapimet, tërheqja e litarit, rrëzimi i duarve dhe pehlivanët.

Kosova është e pasur me trashëgimi etnografike, e cila nuk është zhdukur tërësisht. Kjo trashëgimi sot ruhet nëpër muze të Kosovës, në koleksione dhe shtëpi private, dyqane, ansamble folklorike etj. Ajo studiohet dhe hulumtohet nga profesionistët dhe në një të ardhme përbën një potencial të rëndësishëm të turizmit kulturor. (Shpresa Siqeca)

ETNOLOGJIA. Shkencë që studion jetën e njeriut si qenie shoqërore, përkatësisht jetën e popullit me të gjitha manifestimet e saj. Etnologjia studion kulturën, me trashëgiminë etnokulturore, veçoritë e banimit e të vendbanimeve, mjeshtëritë e ndryshme si shprehje të aktiviteteve ekonomike, veshjet popullore, ushqimin popullor, mjekësinë popullore, meteorologjinë popullore etj. Në fushën e traditës shoqërore vendin kryesor e zënë familja dhe organizimi i vjetër shoqëror, duke përfshirë njësitë më kryesore organizative e vepruese. Kosova nuk ka ndonjë traditë të trajtimit etnologjik të këtyre dukurive shoqërore. Deri në vitin 2000, kur u themelua katedra e etnologjisë, prania e studimeve etnologjike në Kosovë është mbështetur në raste individuale të punës së disa personaliteteve nga kjo fushë. Etnologjia tregon interes të veçantë për rregullat dhe të drejtën e pashkruar dokësore, zakonore ose popullore, me instrumentet e saj zbatuese dhe me fleksibilitetin e mënyrës së nxjerrjes së vendimeve dhe të zbatimit të tyre. Nga traditat e jetës artistike, etnologjia interesohet për këngët, për vallet, për organologjinë, për teatrin dhe për aktrimin popullor etj. Dijen etnologjike disa e shohin të kategorizuar si: shkalla e parë, si

shkencë përshkruese me emërtimin etnografia; shkalla e dytë, etnologji, që merret me shkoqitje e analiza dhe shkalla e tretë si antropologji, që sintetizon, nxjerr përfundime dhe ndërton teori. Etnologjia e sotme e avancuar nuk e pranon një shkallëzim të këtyllë, por për bazë merr realitetin dhe punën shkencore. Këtë praktikë e ndjek edhe programi studimor i departamentit të etnologjisë në Universitetin e Prishtinës. (Drita Halimi-Statovci)

ETNOMUZIKOLOGJIA. Shkencë që hulumton muzikën e popujve të ndryshëm. Është një nga degët më të reja të shkencave muzikologjike. Më me hov ka filluar të zhvillohet në fund të shek XIX, kur u arrit mundësia e incizimit mekanik-fonografik dhe matja, caktimi i saktë i lartësisë së tingujve që mundësoi shënimin në hollësi të melodive të përcjellë brez pas brezi. Termi etnomuzikologji kohët e fundit përdoret krahas termit muzikë komparative. Në kuptim më të gjerë, emërtimi folklor muzikor, që është përdorur më parë, e përcakton elementin hulumtues të kësaj dege shkencore. Lëndë e etnomuzikologjisë konsiderohet muzika folklorike e të gjithë popujve, pavarësisht sa është zhvilluar ajo te një popull a te një tjetër. Ndër etnomuzikologë të njohur ndërkombëtarë janë: J. Kunst, C. Marcel-Dubois, C. Brailoiu, V. Zhganec, B. Nettl etj. Ndër etnomuzikologët shqiptarë që kanë studiuar, hulumtuar, shkruar e publikuar punime, si dhe janë prezentuar me trajtesa nga kjo fushë konsiderohen: Ramadan Sokoli, Lorenc Antoni, Rexhep Munishi, Bahtir Sheholli, Sokol Shupo, Vasil Tole etj. (Zeqirja Ballata)

ETUTA. Princeshë e Dardanisë dhe mbretëreshë e Ilirisë, vajzë e mbretit dardan Monunit dhe grua e mbretit ilir Gentit. Jetoj në shekullin II p.e.r. dhe njihet me emrin Etleva. Martesa e saj me Gentin ishte martesë dinastike dhe kishte për qëllim forcimin e lidhjeve midis shtetit dardan dhe atij ilir. Etuta duhej të martohej me Platorin, vëllanë e Gentit, të cilin ky e vrau për ta marrë pushtetin. Jetoj në Shkodër, në kryeqytetin e shtetit ilir. U mor peng në Romë kur romakët e mposhtën shtetin ilir (168 p.e.r.), bashkë me mbretin Gent, dy djemtë (Skerdilaidin, Pleuratin), vjehrrën, kunatin Karavantin dhe gjithë aristokracinë ilire. Në shkurt të vitit 167 p.e.r. u zhvillua procesioni triumfal në Romë për nder të pretorit L. A. Gallus për fitoren e tij mbi shtetin

ilir. Në procesion u defilua me prenë e pasur ilire: pajisjet ushtarake, orenditë mbretërore, 27 pund ari dhe 19 argjend, 13,000 denarë dhe 120 mijë copa argjendi. Senati romak urdhëroi vendosjen e tyre në Spoleto, por kundërshtimi i banorëve bëri që t'i transferonin në Gubio (Iguvium) të Umbrisë (Itali), ku mendohet të jetë varri i tyre. (Edi Shukriu)

ETHEMI Sabedin (1944-). Piktur. Lindi në Preshevë. Shkollimin e kreu në Preshevë dhe në Pejë. Studimet i kreu në Fakultetin e Arteve në Beograd. Në fillim punoi si mësimdhënës i artit në gjimnazin e Preshevës. Më pastaj një kohë ishte skenograf në Televizionin e Prishtinës. Për katër vjet ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve në Tetovë e më pastaj në Fakultetin e Arteve në Prishtinë për lëndën vizatim i lirë. Mori pjesë në disa ekspozita kolektive, si në Aleksandri, Tiranë, Bruksel, Shkup dhe në ekspozitat e organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës dhe të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Preshevës. (Bislim Aliu)

ETHET HEMORRAGJIKE KRIME-KONGO. Është sëmundje ngjitëse akute virale, që karakterizohet me sindromë të theksuar të gjakderdhjes. Shkaktohet nga virusi me po të njëjtin emër. Virus i është izoluar nga delet, gjedhet, dhitë, lepujt, iriqët, minjtë, te 30 specie të këpushave, te 28 lloje të ixodeve dhe 2 lloje të argasideve. Sëmundja bartet te njeriu pas pickimit të rriqrës së infektuar dhe kontaktit me eksekrete dhe sekrete të të sëmurit. Inkubacioni zgjat prej 1-3 ditë, maksimalisht deri në 9 ditë pas pickimit të këpushës dhe prej 5-6 ditë, maksimalisht 13 ditë në rast të kontaktit me gjakun dhe indet e të sëmurit. Fillimi i sëmundjes është i papritur dhe karakterizohet me temperaturë të lartë (39-40°C), dhembje muskujsh, marramendje, shtangim qafe, dhembje të shpinës, kokës, nyjave, konjuktivit dhe sindromave hemorragjike. Kosova gjendet në brezin ekuatorial të 40°, ku janë të pranishme rriqrat bartëse të infeksionit. Zonat endemike gjenden në Kosovën Qendrore dhe Jugperëndimore. Rastet e para janë shënuar në vitin 1954 në Nishor të Suharekës me 8 vdekje, në vitin 1956 shënohet një rast në Samadrexhë, po ashtu në Suharekë. Që nga kjo kohë, sëmundja paraqitet në formë sporadike dhe epidemike. Në periudhën 1995-2014

në Kosovë janë shënuar 239 raste të etheve hemorragjike, me 61 vdekje, kryesisht në komunën e Malishevës. (Isme Humolli)

EVANS Artur (Arthur) (1851-1941). Arkeolog britanik, publicist, politikan, filantrop. U njoh pas zbulimit të kulturës së Kretës të epokës së bronzit. I pari e definoi shkrimin linear A dhe B. Lindi në Nash Mills (Britani e Madhe) dhe ishte djalë i studiuesit të parahistorisë, sër Xhon Evans. I kreu studimet në Kolegjin Brasenose të Universitetit të Oksfordit (1874) dhe studioi edhe në Universitetin e Gotingenit (Suedi, 1875). Në vitin 1877 u dërgua si korrespondent i gazetës “Manchester Guardian” në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa në vitin 1882 u arrestua nga autoritetet austro-hungareze, për shkak të shkrimeve kundër pushtimit të tyre. Në vitin 1884 u punësua në Muzeun Ashmolean dhe gjatë punës 25-vjeçare e shndërroi në muze arkeologjik me famë botërore. Në vitin 1885 vizitoi disa territore shqiptare, kryesisht në Vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit, të cilave u referohet si Dardania Antike. Pos përshkrimit

në detaje të gjendjes së vështirë të popullatës nën sundimin osman, sidomos të asaj të krishterë, ofroi shumë të dhëna arkeologjike. Të rëndësishme janë studimet mbi rrugët dhe stacionet e periudhës romake në Ballkan, si dhe të dhënat për Kosovën, sidomos për lokalitetin te Soçanica, të identifikuar pastaj si municipium DD. (Pleurat Kabashi)

EVAZIONI I TATIMEVE. Quhet ndryshe evazion fiskal dhe paraqet praktikën ilegale të shmangies së qëllimshme të individëve, të organizatave ose bizneseve nga obligimet tatimore. Për pjesën më të madhe të vendeve, evazoni fiskal trajtohet si vepër penale. Ka një dallim esencial në mes të evazionit të tatimeve dhe shmangies së tatimeve. Përderisa e para është aktivitet ilegal dhe trajtohet si akt kriminal, e dyta përfshin gjetjen e hapësirave ligjore që lejon zvogëlimin e obligimit tatimor për një subjekt të caktuar. Në Kosovë, përgjatë periudhës 2008-2015, vlerësohet se rreth 35-40% e shitjeve të bizneseve nuk janë deklaruar për tatim. (Lumir Abdixhiku)

Ë

ËLBERG Herman (Hermann Ölberg) (1922-). Gjuhëtar, profesor austriak. Ishte profesor në Universitetin e Insbrukut (Austri). Është habilituar më 1972. Punën më të frytshme



HERMAN ËLBERG

ua ka kushtuar studimeve diakronike të shqipes, sidomos në fushën e fonetikës dhe të fonologjisë. Ka shkruar për laringalet e shqipes: “Disa vrojtime për teorinë e laringaleve (mbi bazë të shqipes)” (Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie (An Hand des Albanischen, 1972), “Dy apo tri radhë gutturalesh? Të para nga shqipja” (Zwei oder drei Gutturalreihen? Vom Albanischen aus gesehen, 1976). Ndër punimet e tjera mund të veçohen: “Albanica I: Mbi këmbimin r/l” (Albanica I: Zum r/l-Wechsel, 1967), “Indoeuropianishtja k’ para u në shqipen (Idg. k’ vor u im Albanischen, 1968), “Raportet gjuhësore greko-shqiptare” (Griechisch-albanische Sprachbeziehungen, 1972), “Mbi neutralizimin e k qiellzore dhe velarë para likuidave (Zur Neutralisierung von

palatalem und velarem k vor Liquida, 1972), “Reflektime për autoktoninë e shqiptarëve në Siujdhesën Ballkanike” (Einige Überlegungen zur Autochthonie der Albaner auf der Balkanhalbinsel, 1977), “Ndihmesa e gjuhësisë për atdheun ballkanik të shqiptarëve, 1982, të botuar në shqipen po atë vit” (Beitrag der Sprachwissenschaft für die Balkanheimat der Albaner”), “Rëndësia e elementit latin për rindërtimin e gjuhës shqipe” (L’Importanza del elemento latino per la ricostruzione della lingua Albanese, 1990). Ka pasur një festshrift për të më 1987. Më 2013 u botua habilitacioni i tij i vitit 1972: “Shqyrtime për leksikun indoeuropian të shqipes dhe për fonologjinë diakronike mbi bazë të sistemit vokalik” (Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie auf Grund des Vokalsystem”). Ka redaktuar vëllime që lidhen me albanologjinë dhe ka organizuar një kolokuium ndërkombëtar albanologjik kushtuar Joklit. Më 1972 hapi lektoratin e shqipes në Insbruk. Mbron idenë e prejardhjes ilire të shqiptarëve. Është Doktor Honoris Causa i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. (Kadire Binaj)

F

FABRIKA “COCA-COLA”, LIPJAN. E themeluar në vitin 1977, fillimisht ishte repart i kombinatit të pijeve “Slovin” nga Sllovenia, si pjesë e kompanisë multinacionale me këtë emër. “Slovin” kishte për detyrë sigurimin e të gjitha lëndëve të para. Fabrika në Lipjan kishte një linjë prodhimi prej 600 litrash në orë, përkatësisht 120,000,000 litra në vit. Prodhimi dhe konsumi i “Coca-Cola-s” varej nga stinët e vitit. Në fabrikën e Lipjanit ishin të punësuar 212 punëtorë, prej tyre 25 kishin diploma universitare. Në vitin 1990 Serbia futi masa dhe dhunshme në këtë fabrikë, duke larguar nga puna të gjithë punëtorët shqiptarë, që kishte si pasojë ndërprerjen e prodhimit dhe mbylljen e fabrikës. Pas çlirimit të Kosovës, në objektet e fabrikës u vendos KFOR-i irlandez, por me kërkesë të punëtorëve objekti u lirua dhe fabrika filloi prodhimin sërish. Mirëpo, pas disa ditësh prodhimi u ndërpre, me ndërhyrjen e KFOR-it, për shkak se nuk ishte siguruar licenca për prodhim. Ndërkohë, objektet e fabrikës u privatizuan dhe tani ato shërbejnë si depo. (Shefqet Rashani)

FABRIKA “GORENJE-ELEKTROMOTORËT”, GJAKOVË. Prodhonte elektromotorë dhe pompa për programin e teknikës së bardhë për amvisëri, për elektroindustrinë e Nishit (Serbi). Nga viti 1978 elektromotorët për lavatriçe dërgoheshin në Fabrikën “Gorenje” të Sllovenisë. Më 1979 fabrika nënshkroi kontratë 10-vjeçare me kompaninë “Necchi” në Itali për prodhimin e kompresorëve për frigoriferë dhe katër vjet më vonë ajo u shkëput nga fabrika e elektromotorëve në Nish dhe i bashkëngjitet Fabrikës “Gorenje” të Sllovenisë dhe merr emrin “Gorenje Elektromotorët”. Aftësitë prodhuese të fabrikës ishin 400,000 copë/vit elektromotorë për lavatriçe, 500,000 copë/vit

elektromotorë për kompresorë të frigoriferëve dhe 40,000 copë/vit elektromotorë industrialë. Prodhimet e saj janë eksportuar në shumë shtete, si: Itali, Gjermani, Turqi, Çekosllovakia, Rusi etj. Në bashkëpunim me kompaninë “Danfoss” të Danimarkës, u instalua vija e re e prodhimit të elektromotorëve për kompresorë me aftësi 800,000 copë/vit për nevojat e industrisë së frigoriferëve për “Danfoss” në Danimarkë dhe në Gjermani. Fabrika “Gorenje-Elektromotorët” e ka vazhduar aktivitetin prodhues deri në vitin 2003. (Vjollca Komoni).

FABRIKA “METALIKU”, GJAKOVË. Ndërmarrje industriale metalpërpunuese, e cila e ka zanafillën nga një kooperativë zejtare me 11 punëtorë (1948), për t’u shndërruar katër



PAMJE E FABRIKËS “METALIKU”

dekada më vonë në një objekt industrial me peshë, me mbi 1200 të punësuar. Pas integritimit në “Trepçë”, “Metaliku” filloi hartimin e programeve të reja të bazuara në finalizimin e metalit të zinkut. Prodhimet e “Metalikut” ishin enët e zinkuara e të teflonit, litarët dhe gypat e standardeve të ndryshme, rrjeta e

armatura, gypat e zinkuar dhe prodhimet e kordit. "Metaliku" përfshinte këto objekte: 1) Fabrikën e enëve të zinkuara e të teflonizuara; 2) Fabrikën e telit dhe të litarëve të çelikut; 3) Fabrikën e gypave të zinkuar; 4) Fabrikën e rretave të armaturave (në Deçan) dhe 5) Fabrikën e kordit. Fabrika e enëve të zinkuara dhe e teflonit ishte më e vjetra në kuadër të "Metalikut" dhe e vetmja në ish-Jugosllavi. Enët e teflonit eksportoheshin në Francë, Jordani, Kuvajt, Iran etj. Prodhimi vjetor arrinte 1,935 tonë. Fabrika e telit dhe e litarëve të çelikut kishte një sipërfaqe prej 11,412 m², me aftësi prej 11,000 tonë prodhim në vit. Fabrika e gypave prodhonte 52,000 tonë produkte në vit. Fabrika e kordit ishte e vetmja e këtij lloji në ish-Jugosllavi. Kishte aftësi prodhuese prej 1,500 tonë produkte në vit. Sasia e zinkut nga Metalurgjia e "Trepçës", që finalizohet në fabrikat e "Metalikut", sillej rreth 7,500 tonë në vit. Pas vitit 1999 fabrika u shkatërrua në tërësi. (Minir Dushi)

FABRIKA "SILCAPOR", KAÇANIK. U themelua nga bashkimi i punëve dhe i mjeteve ndërmjet ish-organizatë punuese "Sharri" të Hanit të Elezit dhe "Gradina" e Pulës, Kroaci



(1988). Fabrika "Silcapor" ka qenë ndërmarrje shoqërore në kuadër të organizatës punuese "Sharri". Këtë status e ka pasur deri në vitin 1992 kur "Sharri" u transformua në shoqëri aksionare. Nga qershori i vitit 1999, fabrika u menaxhua nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, ndërsa në vitin 2005 përfshihet në planin shtetëror të privatizimit. "Unio Commerc" nga Hani i Elezit e privatizoi fabrikën "Silcapor" dhe përparoi programin e prodhimit për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në cilësi, në teknologji dhe

në mbrojtje mjedisore. "Silcapor" prodhon parafabrikate të materialit ndërtimor, me veçori të larta të izolimit të energjisë në brendinë e ambientit jetësor, masë të lehtë vëllimore me prejardhje mineralogjike inorganike. Fabrika përbehet nga dy linja prodhuese teknologjike për prodhimin e blloqeve dhe pllakave izoluese, si dhe për prodhimin e elementeve të armuara. Aftësia prodhuese e fabrikës është 220,000 m³ blloqe dhe elemente të armuara në vit. Furnizon tregun e Kosovës dhe plason prodhimet e saj në Maqedoni dhe Shqipëri. Aktualisht fabrika synon ngritjen e laboratorit për ekzaminimin e prodhimeve sipas standardeve ndërkombëtare. (Misini Misini).

FABRIKA "VINEX", VITI. U themelua në vitin 1974. Veprimtari e kësaj fabrike ishte përpunimi i metaleve me prerje dhe me derdhje. Numri i punëtorëve ka ndryshuar prej 250 deri në 510 (1990). Prodhimet e "Vinex-it" ishin vidat e dadot M2, M8, M16-M22 mm, pastaj dorezat për mobile dhe pjesë të tjera me derdhje nga legurat e zinkut. Lënda e parë është siguruar në fillim nga Gjermania e më vonë nga Kombinati Metalurgjik i Zenicës në Bosnjë e Hercegovinë, ndërsa legura e zinkut nga kombinati "Trepça". Prodhimi arrinte deri në 8,000 tonë në vit. Shumica e prodhimit eksportohej në Gjermani, Poloni, BRSS, Çekosllovakia, Irak, Iran etj. Në Kosovë blerësit kryesorë kanë qenë "Jugotermi" i Gjilanit, "Amortizatorët" e Prishtinës, fabrika e pjesëve të automobilave "Ramiz Sadiku" në Pejë etj. Në vitin 1990 të gjithë punëtorët shqiptarë u nxorën nga puna dhe ndërmarrja u shkatërrua. "Vinex-i" kishte në pronësi 5.2 ha tokë, 12,800 m² objekte të prodhimit dhe 150 makina moderne në gjendje të rregullt pune. Në vitin 2006 ndërmarrja u privatizua. (Fehmi Krasniqi).

FABRIKA E AKUMULATORËVE, MITROVICË. Kapacitetet e para të finalizimit të metalit të plumbit në kombinatin "Trepça" kanë filluar me ndërtimin e kësaj fabrike në Mitrovicë në vitin 1968. Fabrika është ndërtuar sipas licencës së firmës gjermane "Varta", me aftësi prodhuese 6,000 tonë akumulatorësh "starter" në vit. Asokohe kërkesat në treg për akumulatorë ishin të mëdha, për shkak të zhvillimit të madh të industrisë automobilistike. Duke qenë me përbërje rreth 90% Pb,

akumulatorët ishin prodhimi më i rëndësishëm i përpunimit industrial të këtij metali. Në vitin 1989 nga gjithë prodhimi vjetor i Pb në kombinatin “Trepça” (69,000 t), 53% u përdor për prodhimin e akumulatorëve. Fabrika e akumulatorëve në Mitrovicë ishte bartëse e prodhimit dhe e investimeve në fabrika të tjera të akumulatorëve në Kosovë, në Pejë dhe në Gjilan, si dhe në zgjerimin e aftësive të veta prodhuese në sasinë prej 9,000 tonë në vit, pastaj në ndërtimin e repartit të motobaterive, të akumulatorëve prej 180 Ah dhe baterive industriale. “Trepça” kishte një prodhim të përgjithshëm të akumulatorëve të ndryshëm (“starter” G, F dhe PP, motobaterive dhe akumulatorëve industrialë) prej 35,000 tonë në vit. Kjo fabrikë ende është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. (Minir Dushi)

FABRIKA E ARMATURAVE TË NDËRTIMTARISË (FAN), PODUJEVË. U ngrit në vitin 1983 me financat e të ashtuquajturit fond federativ i Jugosllavisë për vise të pazhvilluara. Ndërtimet i kreu Kombinati Metalurgjik nga Zenica e Bosnjës. Prodhimet kryesore të FAN-it janë: rrjetat e salduara nga teli me përmasa 04-012 mm, të mbajtësve kapriatë 04-010 mm, të shufrave shtesë për trarë, tel i tërhequr që shitet si gjysmëprodhim, armaturë klasike nga 04-032 mm dhe trarë meskatësh. Makinat dhe pajisjet e instaluar, si dhe infrastruktura me objekte përcjellëse ishin ndër më bashkëkohoret për kohën. Në periudhën 1984-1990 fabrika kishte rreth 400 punëtorë kur prodhimi zhvillohej në katër turne. Sasia e prodhimit arrinte afër 35,000 tonë në vit. Fabrika zë një sipërfaqe prej afër 8 ha. Në vitin 1990 Qeveria e Serbisë vuri masat dhunshme në fabrikë dhe largoi nga puna kuadrin udhëheqës shqiptar. Në vitin 2006 fabrika u privatizua. (Fehmi Krasniqi).

FABRIKA E BATERIVE INDUSTRIALE “TREPÇA”, PEJË. Ka prodhuar bateri industriale të plumbit, sipas teknologjisë gjermane “Varta”. Bateritë e para janë prodhuar nga fundi i vitit 1980. Kapacitetet prodhuese kanë qenë rreth 12,000 tonë në vit, që e radhiste fabrikën ndër prodhuesit më të mëdhenj në Europë. Fabrika në vitin e parë arriti t'i përmbushte obligimet e kontratave ndaj Rusisë dhe blerësve të tjerë, me një sasi prodhimi prej 5,234 tonë të baterive tracionare dhe

stacionare. Me rritjen e kërkesës u rrit edhe prodhimi, i cili në vitin 1987 arriti në 10,016 tonë. Me mbi 600 të punësuar, Fabrika e Baterive Industriale luajti rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të komunës së Pejës. Në vitin 1990 Republika e Serbisë aplikoi masat e dhunshme dhe largoi punëtorët shqiptarë nga puna. Në vitin 1999 punëtorët u kthyen dhe u përpoqën të rifillojnë prodhimin. Në vitin 2000 fabrika u regjistrua si ndërmarrje shoqërore dhe me këtë veprim u legalizua veprimtaria e saj ekonomike deri në privatizim (2013). Me vendim për privatizim, fabrika u riemërua në “FBI Trepça sh.p.k.”, duke vazhduar prodhimin e baterive industriale, por me sasi shumë të vogël. (Vjollca Komoni).

FABRIKA E BATERIVE NI-CD, GJILAN. U themelua si ndërmarrje shoqërore e pavarur nga kombinati “Trepça”. Veprimtaria kryesore e ndërmarrjes ka qenë prodhimi i baterive Ni-Cd të hapura dhe të mbyllura dhe i baterive të litiumit (Li-SOCl₂, Litium Tionil klorid), pastaj prodhimi i disa llojeve të pllakave elektronike, i llambave elektrike të tipave të ndryshëm etj. Kishte repartet e veta prodhuese në Gjilan, Viti, Partesh dhe Kamenicë. Teknologjia e prodhimit u mor nga Marathon Batteries (Teksas) dhe Battery Engineerg (Masachusetts), SHBA, ndërsa lënda e parë importohet nga Britania e Madhe, SHBA-ja, Kanadaja, Gjermania dhe Rusia. Nga kombinati “Trepça” si lëndë e parë merrej vetëm kadmiumi (Cd). Prodhimet e kësaj ndërmarrjeje janë plusuar në tregun vendor, për qëllime ushtarake dhe civile, si dhe është eksportuar në shtetet e Europës, në SHBA, BRSS dhe në shtetet e Lindjes së Mesme. Në periudhën e suksesshme kishte të punësuar rreth 600 punëtorë dhe kapacitetet e instaluar prodhuese arrinin në 15 milionë Ah/vit të baterive Ni-Cd. Fabrika ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të rajonit të Anamoravës dhe të Kosovës. Veprimtarinë e suksesshme e vazhdoi deri në vitin 1992, e riemëruar si Industria e Baterive, Gjilan. Pas privatizimit fabrika mban emrin “New Co IBG Batteries”. (Vjollca Komoni).

FABRIKA E BIRRËS, PEJË. U ndërtua në vitin 1971 në kuadër të Kombinatit bujqësor industrial “Peja”. Kombinati përfshinte katër fabrika: fabrikën e sheqerit, të alkoolit, të birrës dhe të maltit. Aftësia fillestare e prodhimit



FABRIKA E BIRRËS NË PEJË

ishte 300 mijë hektolitër birrë në vit. Fabrika e birrës hynte në radhën e fabrikave më moderne në ish-Jugosllavi. Në vitin 2006 u privatizua nga “Lashko Grup/Union” nga Sllovenia dhe nga disa biznesmenë vendorë. Në fabrikë janë të punësuar 213 punëtorë. Kompleksi i fabrikës përfshin sipërfaqen prej 24 ha, me tërë infrastrukturën e saj. Aftësia e tanishme e prodhimit është 900 mijë hektolitër birrë në vit. Që nga privatizimi është investuar në linja të reja prodhuese të teknologjisë, të energjetikës, infrastrukturës, marketingut, si dhe në sektorë të tjerë. Që nga viti 2010 “Birra Peja” është prodhuese edhe i asortimentit të ujit dhe të lëngjeve. Nga qershori i vitit 2014 pronar i fabrikës është “Devolli Grup”. Asortimenti i prodhimit tani përfshin: birrë “Pilsner” në shishe, kanoçe, fuçi krikllë, birrë “Premium” në shishe, birrë zero pa alkool në shishe, ujë dhe lëngje. Prodhimi i Fabrikës së birrës në vitin 2014 ishte 250,000 hektolitër birrë dhe 130,000 hektolitër pije joalkoolike, ujë dhe lëngje. (Nushe Lajçi)

FABRIKA E ÇIMENTOS “SHARRCEM”, HANI I ELEZIT. Është fabrika e vetme e çimentos në Kosovë, e themeluar në vitin 1936 me një furrë vertikale me aftësi prodhimi prej 4,415 tonë në vit. Më 1972 montohet furra rrotulluese me ftohës satelit, duke rritur prodhimin në 180,000 tonë në vit. Në vitin 2000 fabrika “Sharrcem” përfshihet në planin shtetëror të privatizimit. Në vitin 2010 “Titan Group” vë në veprim një program ambicioz të modernizimit të fabrikës për arritjen e standardeve ndërkombëtare në cilësi, teknologji dhe mbrojtje të mjedisit. Më 2012 përmbillet faza e parë e avancimit teknologjik, duke e rritur efikasitetin e prodhimit. Fabrika



FABRIKA E ÇIMENTOS “SHARRCEM”

është certifikuar për cilësi (ISO 9001), duke zbatuar sistemin i menaxhimit të CO2, ISO 14001, OHSAS ISO 18001, për menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë në punë. Më 2014 fabrika mori licencën e parë IPPC në Kosovë (Kontrolli i integruar për parandalimin e ndotjes). Kompania, duke ndjekur incizimin hidrogeologjik ka projektuar një fabrikë për trajtimin e mbeturinave me ujë (2015), si dhe ka kryer programin për zbutjen e zhurmës për të gjitha pajisjet. Në vazhden e përpjekjeve për të rritur asortimentin e prodhimeve, përveç katër prodhimeve ekzistuese të certifikuara me certifikatë europiane, fabrika “Sharrcem” është në përfundim të laboratorit të betonit me të gjitha pajisjet përkatëse. Kujdes i veçantë në fabrikë i është kushtuar pakësimit të kromit, duke respektuar përkufizimin europian të vitit 2005. Ndërkohë, “Sharrcem” ka dorëzuar dy plane të rëndësishme të investimeve: njërin për prodhimin e karburanteve të ngurta pluhur dhe një tjetër për ndërtimin e një uzine për prodhimin e energjisë nga mbeturinat e papërpunuara. Prodhimet e “Sharrcemit” plasohen në tregun e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Serbisë. (Misin Misini).

FABRIKA E FIJEVE SINTETIKE, PRIZREN. E themeluar në vitin 1975, fabrika prodhonte shumë lloje të fijeve sintetike, të cilat shërbenin si lëndë e parë për një asortiment të gjerë prodhimesh. Prodhimet shfrytëzoheshin për nevoja të brendshme, por edhe për eksport. Në fabrikë ishin të punësuar deri në 700 punëtorë. Pas futjes së masave të dhunshme nga ana e Serbisë (1990), fabrika ndërpreu prodhimin dhe pushoi nga puna të gjithë punëtorët shqiptarë. Pas çlirimit të Kosovës objektet e fabrikës u privatizuan dhe tani ato shërbejnë

si depo, ndërsa pajisjet janë larguar nga këto objekte. (Shefqet Rashani)

FABRIKA E GYPAVE, FERIZAJ. E themeluar në vitin 1972, program kryesor e kishte prodhimin e gypave të çelikut me saldim spiral prej Ø 355, 6-2032 mm, me trashësi të murit



FABRIKA E GYPAVE NË FERIZAJ

3, 96-12,7 mm, sipas standardit gjerman DIN, të cilët gjejnë përdorim në bartjen e naftës, gazit natyror, propan-butan gazit si dhe ujit të ngrohtë. Me aftësitë e instaluara dhe cilësinë e prodhimit ishte një ndër ndërmarrjet më të mëdha në fushën e prodhimit të gypave të çeliktë me saldim me tegel spiral në rajon. Teknologjia e përparuar, pajisjet gjermane dhe stafi udhëheqës profesional garantonin cilësitë e prodhimeve, duke mundësuar prodhimin e gypave në përputhje me kërkesat e standardeve botërore. Duke u bazuar në kërkesat e tregut u bë edhe zgjerimi i programit të prodhimit të gypave me tegel drejtvizor me saldim me rrymë të frekuencës së lartë (HF-ERW, në vitin 1981) nga kualiteti i çelikut J55 API 5CT, H40 API 5CT si dhe S235JRG2 me diametër Ø 114,3-406,4 dhe trashësi të murit 3,2-12,7 mm. Njëherësh bëhet mbrojtja sipërfaqësore e gypave nga korrozioni me masa epokside izolimi. Kjo ndërmarrje është privatizuar në vitin 2008 dhe, si pjesë e grupit “Mabetex”, vepron si ndërmarrje e re. (Fehmi Krasniqi).

FABRIKA E LLAMARINËS SË ZINKUAR, VUSHTRRI. Ishte organizatë punuese në përbërje të Kombinatis “Trepça”, e themeluar në vitin 1977. Teknologjia e kësaj fabrike mundësonte asortiment të zgjeruar të prodhimeve. Në fillim u vu në funksion linja e procesit të zinkimit të llamarinës (galvanizimit),



NJË REPART I FABRIKËS “LLAMKOS” NË VUSHTRRI

me teknologji franceze moderne për kohën. Edhe tani është ndër fabrikat më moderne në Ballkan dhe më gjerë. Projektuese ishte firma „DMS” nga Franca. Fabrika nxjerr prodhim cilësor, duke kryer veshjen e llamarinës me zink deri 250 g/m², në të dy anët. Fillimisht ka pasur të punësuar rreth 400 punëtorë, nga të cilët pjesa menaxhuese dhe ekzekutive e prodhimit, e mirëmbajtjes dhe e kontrollit të cilësisë është specializuar në Francë dhe Zvicër. Në sajë të rezultateve të mira të fabrikës ajo u zgjerua dhe më vonë në të u punësuan edhe 150 punëtorë të tjerë. Kapaciteti i galvanizimit të kësaj fabrike është 120,000 tonë në vit. Në fabrikë bëhet profilimi i llamarinës, prerja në gjatësi “sliter”, prodhimi i gypave për ajrim e klimatizim me elemente fazonike, kanale për fluide, ulluqe të ndryshme, kontejnerë mobilë dhe statikë etj. Fabrika e Lllamarinës në Vushtri u privatizua më 2011 nga konzorciumi anglez “Core Group”. Në vitin 2012 “Llamkos Galva Steel” ishte prodhuesi më i madh i llamarinës së zinkuar në rajon. (Hysni Osmani)

FABRIKA E MUNICIONIT TË GJUE TISË, SKËNDERAJ. Ishte ndërmarrje punuese e kombinatis “Trepça”, e cila u fut në prodhim në vitin 1977. Numri i të punësuarve ishte 355. Fabrika funksionoi sipas teknologjisë së firmës së njohur belge “La Chausse”, me dy sektorë prodhimi: përpunimi i plumbit dhe i plastikës. Kapacitetet e fabrikës ishin këto: 60 milionë patrona të plotë për gjueti, 750 tonë saçme e derdhur nga plumbi, 4,500 saçme e farkuar nga plumbi, 2,500 tonë gypa plumbi, 3,000 tonë fije plumbi, 2,500 tonë profile plumbi, 6 milionë copë peshoja balancuese për goma të automobilave dhe 100,000 copë kova plastike.

Për nga teknologjia, fabrika ishte ndër më të mirat në rajon. Prodhimet e saj, rreth 40% , shiteshin në tregjet e jashtme, si në Francë, Itali, Suedi, Danimarkë, Liban, SHBA, Kanada etj. Pas masave të dhunshme të regjimit serb në vitin 1998, të plaçkitjes së prodhimit dhe pajisjeve, si dhe të kthimit të saj në bazë ushtarake serbe, nga e cila u bënë reprezalje të shumta kundër popullatës së Drenicës dhe pas bombardimeve të NATO-s, fabrika u shkatërrua pothuajse në tërësi. (Asllan Vitaku)

FABRIKA E NGJYRAVE DHE E LLAKUT, VUSHTRI. U themelua në vitin 1974, për prodhimin dhe ambalazhimin e ngjyrave të vajit dhe atyre antikoroze, për mbrojtje nga oksidimi i objekteve dhe i pajisjeve industriale, si “Trepça”, Korporata Elektroenergjetike etj. Më vonë, fabrika u riorientua në zhvillimin e prodhimeve të artikujve kimikë me litrazh të vogël, sipas kërkesave të tregut. Në fillim fabrika ishte pjesë e kombinatit “Trepça”, derisa u privatizua në vitin 2006 me emërtimin e ri - Ndërmarrja private shërbyese “Extra-Collors”, Vushtrri. Veprimtaria themelore e fabrikës është prodhimi ngjyrave dhe i llakut sipas teknologjisë gjermane “NeoLinger”. Fabrika ka dy linja prodhimi: për prodhimin e ngjyrave të lëngëta (polikolori, poliesteri, ngjyrat antikoroze, me bazë akrilike etj.) dhe linjën për prodhimin e ngjyrave të ngurta (ngjitëse të qeramikës, stiropori, graniti, hidroizolimi dy komponentësh, fasade-abrid etj.). Sasia e prodhimit të ngjyrave të lëngëta ishte 800 tonë në vit, kurse e ngjyrave të ngurta 1,200 tonë në vit, me mundësi të arrihet sasia deri në 2,500 tonë në vit. Gjendja e teknologjisë është e nivelit të duhur, me tendencë të ngritjes së sasisë dhe llojeve të prodhimeve për tregjet e jashtme. (Asllan Vitaku)

FABRIKA E PAJIMEVE XEHETARE (“KO-SOVAMONT”), OBILIQ. E themeluar më 1987, është organizatë punuese me makina metalpërpunuese dhe metalprerëse me përmasa të ndryshme. Fabrika e Pajimeve Xehetare ka aftësi tekniko-teknologjike specifike për krejt rajonin, me mundësi të mëdha prodhuese e riparuese. Duke qenë e pajisur me makineri të llojeve të ndryshme dhe më bashkëkohore, ka një gamë të gjerë të prodhimeve, me mundësi për riparimin e mekanizmave dhe pajisjeve që ndodhen në shfrytëzim në mihjet sipërfaqësore

të Mirashit, Bardhit dhe Sibofcit, siç janë boshtet me gjatësi deri në 6 m, tamburet prej 600-1,400 mm, ingranazhet deri në 40 mm, sikundër edhe përpunimi termik i pjesëve të çelikut, riparimi i reduktorëve të thjeshtë dhe planetarë etj. (Avni Terziqi).

FABRIKA E PAJISJEVE TË PROCESIT, MITROVICË. E themeluar në vitin 1955, puna e saj lidhet me eksploatimin e xehes në minierën e “Trepçës” në Stantërg dhe të përpunimit të saj në Zveçan. Në linjat e prodhimit të kësaj fabrike bëhej ndërtimi i konstruksioneve të çelikut, i punimeve elektromekanike, të mirëmbajtjes, të shërbimeve të montimit, të instalimeve minerare, të ajrimit e aklimatizimit, të mbrojtjes antikoroze, prodhimi i vagonëve të minierës etj. Prodhonte edhe rimorkio për ngarkesa 3-10 tonë. Këto punime dhe pajisje kryesisht ishin të orientuara kah objektet prodhuese të reparteve të sistemit të “Trepçës”. Ekipte të shumta të kësaj fabrike morën pjesë në ndërtimin dhe montimin e pajisjeve të çelikut dhe të pjesëve elektromotorike në flotacionin në “Tunel”, në shkretoren e plumbit, në rafineri, në elektrolizën e zinkut, në industrinë kimike dhe në reparte të tjera të “Trepçës”. Kjo fabrikë tani merret me kryerjen e punëve kapitale në miniera dhe flotacione. (Avni Terziqi)

FABRIKA E PASURIMIT TË XEHERORËVE TË PLUMB-ZINKUT, LEPOSAVIQ. E themeluar në vitin 1972, në këtë fabrikë bëhet përpunimi me flotacion i xeherorëve të plumb-zinkut, që nxirret nga grupminierat e Kopaonikut: Bellobërdë, Cernac, Zhuta Perlina dhe Koporiqe, që janë në kuadër të kombinatit “Trepça”. Aftësia përpunuese e flotacionit është 240,000 tonë në vit. Prodhohen dy lloje të koncentrateve: të plumbit në sasi rreth 15,000 tonë në vit (65%-68% Pb) dhe të zinkut rreth 20,000 tonë në vit (45%-49% Zn). Gjatë këtij procedimi prodhohen edhe 350,000 tonë në vit material shterp të shoqëruar me afër 2 milionë m³ ujë industrial. Materiali shterp magazinohet në dy deponi: e vjetra (1972) tani e mbyllur dhe e reja (Bostanishte) që vazhdon të përdoret. Aktualisht në flotacion përpunohen xeherorët e minierave Bellobërdo dhe Cernac. Me futjen në proces të makinave të reja (2013), shfrytëzimet në flotacion janë rritur nga 71.3% (1987) në 93% (2013). (Shyqeri Kelmendi)

FABRIKA E PASURIMIT TË XEHERORIT TË PLUMB-ZINKUT, BADOFC. Fabrika u ndërtua më 1968 për përpunimin e xeherorëve polimetalorë të plumb-zinkut, që nxirren nga grupi i minierave në Badofc, Kishnicë dhe Hajvali, në kuadër të kombinatit "Trepça", ndërsa xeherori nga miniera e Novobërdës (1969-1976) përpunohej në flotacionin në fshatin Marec. Nga viti 1976 xeherori i Novobërdës trajtohet në seksionin e veçantë të ndërtuar në flotacionin e Badofcit. Aftësia përpunuese e flotacionit të Badofcit është 1.1 milionë tonë në vit xeherorë. Prodhoheshin tri lloje të koncentrateve: i plumbit rreth 32,000 tonë në vit (60-65% Pb), i zinkut (42-46% Zn) dhe i piritit (FeS_2) rreth 120,000 tonë në vit. Gjatë procedimit teknologjik për përfitim të këtyre koncentrateve, në flotacion prodhoheshin edhe mbi 700,000 tonë në vit material shterp të shoqëruar me afër 4,5 milionë m^3 ujë industrial. Shfrytëzimi i aftësisë së instaluar në flotacionin e grupminierave Kishnicë-Novobërdë në Badofc ishte 48.1% (1987), kurse shkalla më e lartë e shfrytëzimit ishte 80.2% (1984). Shpeshherë janë shënuar pushime të detyrueshme për shkak të mungesës së xeherorëve. Flotacioni ka nevojë për modernizim, me qëllim të ngritjes së rendimenteve. (Shyqeri Kelmendi)

FABRIKA E PASURIMIT TË XEHERORIT TË PLUMB-ZINKUT, NË TUNEL. Fabrika e pasurimit fillimisht u ndërtua në Zveçan (1930). Ishte flotacioni më i vjetër në Europë. Në vitin 1985 u ndërtua flotacioni i ri në vendbanimin "Tunel" për pasurimin e xeherorëve polimetalorë të plumb-zinkut të minierës së Stantërgut në kuadër të kombinatit "Trepça". Në flotacion prodhohen koncentratet e plumbit (Pb), të zinkut (Zn) dhe të Piritit (FeS_2). Aftësia përpunuese e flotacionit të ri për fazën e parë është 1 milion tonë në vit, me mundësi të zgjerimit në 1,5 milionë tonë në vit për të përpunuar xeherorët e Pb-Zn, në rastin e hapjes së minierave të reja (Zjaça, Mazhiqi, Maja e Madhe). Ndërkaq, për 700,000 tonë xeherorë Pb-Zn në vit nga miniera e Stantërgut, flotacioni prodhon rreth 35,000 tonë koncentrate të Pb (72.5% Pb) dhe rreth 48,000 tonë në vit koncentrat Zn (49% Zn). Gjatë procedimit, përveç koncentrimin të metaleve të tjera të dobishme (Ag, Bi, Sb) prodhohen edhe rreth 620,000 tonë në vit

material shterp, i cili kryesisht rikthehet në minierë si material mbushës, apo deponohet në depon bashkëkohore në fshatin Kelmend. Shfrytëzimi i aftësive të instaluar në flotacionin e minierës së Stantërgut ishte 63.7% (1987), kurse shfrytëzimi më i lartë ishte 70.3% (1984). Janë shënuar edhe pushime të detyrueshme të flotacionit për shkak të mungesës së xeherorëve. Në kuadër të monitorimit dhe të korrigjimit të kohëpaskohshëm të procesit teknologjik, si dhe për nevojat e hulumtimeve shkencore-profesionale, në kuadër të flotacionit është ndërtuar edhe objekti gjysmindustrial me aftësi përpunuese të xeherorit prej 25-75 kg në orë. (Shyqeri Kelmendi)

FABRIKA E PJESËVE TË AUTOMOBILAVE „RAMIZ SADIKU“, PEJË. U themelua në vitin 1965 dhe bënte pjesë në industrinë metalike të mjeteve të komunikacionit në ish-Jugosllavi. Fillimisht në fabrikë ishin të punësuar rreth 600 punëtorë. Me zhvillimin e përparuar, varësisht prej zhvillimit të fabrikave të tjera në kuadër të sistemit „Zastava“ të Kragujevcit (Serbi), fabrika kishte pjesë të programit të vet në komunën e Deçanit dhe të Istogut. Teknologjia e prodhimit për atë kohë ishte e re dhe bashkëkohore. Gjatë vitit 1988 arriti shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve prodhuese, kur u arrit të prodhoheshin pjesët për 160,000 vetura. Numri maksimal i të punësuarve arriti në 2,142 punëtorë. Prodhimet e kësaj fabrike përdorshin kryesisht për vetura të prodhuesit «Zastava» dhe për eksport, sidomos prodhimi i pjesëve metalike të ulëseve të përparme dhe të prapme të programit prodhues të "Fiatit" të Italisë. U prodhuan pjesë për "Fiat Iveco" të Italisë dhe për rroshuasit e automobilave "Pol-mot" të Polonisë. Fabrika pësoi dëme të mëdha gjatë luftës së vitit 1999. Fabrika është privatizuar dhe e ka ndërruar destinimin. (Fehmi Krasniqi)

FABRIKA E PLEHRAVE "AZOTIKU", OBILIQ. E ndërtuar në vitin 1970, fabrika funksionoi në kuadër të kombinatit "Kosova" në Obilic. Fabrika ka prodhuar plehra azotike me 27% azot, me aftësi prodhuese 250,000 tonë në vit. U ndërtua sipas licencës dhe teknologjisë italiane të firmës "Ansaldo" nga Gjenova. Ndërtimi i këtij objekti ka pasur për qëllim prodhimin e amoniakut si lëndë bazë, e cila me përpunimin e mëtejshëm do të prodhonte

plehun azotik, i ashtuquajtur "NAG" 27% N₂. Procesi teknologjik parashihte shfrytëzimin e gazit termik nga reparti i gazifikimit të qymyrit. Në përbërje të Azotikut kanë qenë të përfshirë edhe repartet me rëndësi të veçantë (sinteza e amoniakut, acidi nitrik, prodhimi i plehut azotik, përgatitja e ujit etj.). Aftësitë e projektuara të fabrikës kanë qenë: amoniak 330 tonë në ditë, acidi nitrik 540 tonë në ditë dhe pleh azotik "NAG" 830 tonë në ditë. Plehu azotik i prodhuar në Obiliq është shfrytëzuar për nevojat e agrokompleksit kosovar në sasi rreth 100,000 tonë në vit, kurse pjesa tjetër është eksportuar në vendet e Europës. Kjo fabrikë është shkatërruar në tërësi dhe paraqet problem mjedisor. (Asllan Vitaku)

FABRIKA E PLEHRAVE KIMIKE "TREPÇA", MITROVICË. (1964). Fabrika filloi të ndërtohej në vitin 1964 dhe arriti kapacitetin e plotë prodhues në vitin 1974. Kishte këto aftësi prodhuese: superfosfat pluhur 250,000 tonë në vit, granulate 100,000 tonë në vit, plehra komplekse 144,000 tonë në vit, superfosfat të trefishtë 100,000 tonë në vit, acid fosforik 50,000 tonë në vit, kriolit dhe fluorid alumini nga 3,000 tonë në vit dhe sulfat alumini 5,000 tonë në vit. Lënda e parë (tre kalciumfosfati) importohej, kurse acidi sulfurik sigurohej nga procesi teknologjik në elektrolizën e zinkut në "Trepçë". Si lëndë e parë për prodhimin e plehrave NPK (azot, fosfor dhe kalium) dhe të superfosfatit të trefishtë ishte acidi fosforik. Nga viti 1974 plehrat NPK të tipit 15:15:15% u prodhuan me licencë dhe teknologji franceze "Moritz", gjersa acidi fosforik prodhohej sipas licencës dhe teknologjisë britanike "Fisons". Prodhimet e plehrave NPK dhe të superfosfatit në formë të granular dhe si pluhur janë plasuar në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe janë eksportuar në Turqi dhe Çekosllovakia. Në kuadër të Fabrikës së Plehrave Kimike "Trepça", është aktive vetëm fabrika për prodhimin e kripërave inorganike të sulfat aluminit me aftësi prodhuese 7,000 tonë kripë në vit, e cila shfrytëzohet nga të gjithë ujësjellësit e Kosovës. (Asllan Vitaku)

FABRIKA E POMPAVE ME PISTON, DEÇAN. Fabrika u ndërtua në vitin 1984, me programin jugosllav për zhvillimin e viseve më pak të zhvilluara. Bartës i investimeve ishte Industria e Makinave të Nishit. Fabrika

prodhoi variacione të ndryshme të pompave, siç janë pompat centrifugale shumëshkallëshe, pompat me piston me shtypje të lartë, pompat me piston me shtypje të lartë me elektromotor, të gjitha llojet e valvulave, si dhe bënte sevisimin e të gjitha llojeve të pompave. Puna e suksesshme e fabrikës zgjati deri në suprimimin e autonomisë së Kosovës (1989). Pas vitit 1999 fabrika riemërohet, me programin e prodhimit nga fusha e përpunimit të metaleve. (Xhevat Perjuci)

FABRIKA E QERAMIKËS "KARAÇEVA", KAMENICË. Fabrika e parë e qeramikës në Kamenicë e filloi prodhimin në vitin 1970, me kapacitet ditor 2000 m² pllaka të murit, me përmasa 15 x 15 x 0,6 cm. Fabrika e dytë nisi prodhimin në vitin 1974 dhe ka prodhuar pllaka qeramike për dysheme, me kapacitet ditor 2000-2500 m² përmasa 20 x 20 x 0,8 cm, ndërsa fabrika e tretë nisi prodhimin më 1981, me aftësi punuese ditore 10,000 m² pllaka qeramike për mure me teknologji shumë të përparuar. Ndërkohë u ndërtua edhe fabrika për prodhimin e fritës (emajlit) me kapacitet 6,000-7,000 tonë në vit, që shërbente për prodhimin e pllakave që më parë ishte importuar nga Italia. Numri i të punësuarave në "Karaçevë" ishte mbi 850 sish. Fabrika u ngrit mbi bazë të rezervave të kaolinit në Karaçevë, fshat afër Kamenicës (mbi 3 milionë tonë). Kaolini i Karaçevës ka këtë përbërje: feldspat 40%, kuarc 36%, kaolin 14% dhe hidromuskovitilit-montmorillonit 10% dhe preferohet në çdo industri të qeramikës. Fabrika e re e qeramikës punoi deri në vitin 1999, por me aftësi punuese të reduktuar. Ky kompleks i industrisë qeramike është privatizuar në periudhën 2005-2007. (Fejzullah Krasniqi)

FABRIKA E RADIATORËVE, GJILAN. U themelua në vitin 1978, me emrin "Jugoterm", ndërsa modernizimi i saj u bë në vitin 1984. Tani kjo fabrikë e mban emrin "Enrad". Fabrika i ka dy njësi: në Gjilan, e cila përfshin ndërtesën me sipërfaqe rreth 17,000 m², nga të cilat 13,500 m² përdoren për zhvillimin e procesit të prodhimit dhe njësinë në fshatin Zhegër, me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 3,000 m², nga të cilat 2,600 m² janë të destinuara për zhvillimin e procesit të prodhimit. Ngritja e kapaciteteve të reja ka mundësuar që brenda vitit të prodhohen rreth 1,000,000 m² radiatorë



PAMJE E FABRIKËS SË RADIATORËVE NË GJILAN
panelë në vit dhe më shumë se 4,000 kaldaja dhe stufa për ngrohje. Fabrika gjithashtu prodhoi kaldaja me dru dhe qymyr, kaldaja me pelet, kaldaja elektrike dhe radiatorë elektrikë. Lënda e parë kryesisht sigurohet nga Maqedonia dhe Greqia. Kaldajat dhe radiatorët “Enrad” janë të certifikuar (EN 303-5 dhe DIN- EN 442) nga instituti HLK Shtuttgart, Gjermani, ndërsa sistemi i menaxhimit të cilësisë sipas standardit ISO 9001:2008 është certifikuar nga instituti TÜV Austria Cert. Plasmani i prodhimeve të gatshme bëhet në tregun kosovar (rreth 60% të prodhimit), në shtetet e Ballkanit dhe në tregun sloven. Fabrika u privatizua në vitin 2012 nga kompania “Eng Office ShPK” dhe ka të punësuar rreth 200 punëtorë. (Fejzullah Krasniqi)

FABRIKA E SHEQERIT, PEJË. E ndërtuar në vitin 1962, ishte ndër ndërmarrjet e para industriale në Pejë. Aftësia e prodhimit ishte përpunimi i 180 vagonë me panxharsheqer. Në fillim punoi me kapacitet prej 30%, në vitin 1963 deri në 50%. Vetëm një herë, në vitin 1976, arriti aftësinë prodhuese prej 100%. Viteve të tjera ka punuar me aftësi prodhuese deri në 80%. Në fabrikën e sheqerit ishin të punësuar 130-180 punëtorë të përhershëm, ndërsa gjatë sezonit kanë punuar edhe afro 180 punëtorë sezonalë. Gjatë periudhës së punës janë bërë disa rikonstruktione të pjesshme të fabrikës. Fabrika funksionoi në kuadër të kombinatit bujqësor industrial “Peja” dhe furnizohej me panxharsheqer të kultivuar në Kosovë. Meqenëse kultivimi i panxharsheqerit në Kosovë nuk i plotësonte nevojat e saj, fabrika punoi me aftësi të kufizuar. Në vitin 1988 puna e kësaj fabrike u ndërpre. Në vitin 2006 kaloi në pronësi të Agjencisë Kosovare

të Mirëbesimit dhe repartet e saj janë jashtë përdorimit. (Nushe Lajqi)

FABRIKA E SHKRIRJES SË METALEVE, JANJEVË. Fabrikë që vazhdon traditën e ish-ndërmarrjes “Metalac”, e themeluar në vitin 1948. Fillimisht ishte një kooperativë e zejtarëve dhe më pas u zhvillua në ndërmarrje me rreth 850 punëtorë. Programi prodhues bazohet në shkrirjen e lidhjeve nga alumini (lëndë dytësore për riciklim) dhe prodhimi i lidhjeve në ingot, sipas recepturës laboratorike me kapacitet prej 600 tonë lidhesh në muaj; pastaj shkrirja dhe përpunimi i gizës dhe i metaleve me ngjyrë me derdhje të lirë nga lënda dytësore për riciklim; 80 t/muaj dhe produkte nga programi për kanalizim dhe instalime (puseta të tipave të ndryshme dhe madhësive të ndryshme, pllaka shporeti për amvisëri, sfera për mullinj të flotacioneve) dhe prodhime të tjera. Fabrika ka punuar edhe në programin e industrisë automobilistike, në programin e industrisë pneumatike (piston pneumatik, flanzhe pneumatikë etj.), në programin e lavatriçeve etj. (Hysni Osmani)

FABRIKA E VAJIT, FERIZAJ. Është ndër ndërmarrjet e para industriale në Ferizaj. U themelua në vitin 1948. Në vitin e parë të punës u përpunuan 80 vagonë luledielli dhe u prodhuan 32 tonë vaj. Në vitin 1958 u ndërtua silosi modern me kapacitet prej 3000 tonësh, kurse në vitin 1962 u ndërtua vatra e re. Më 1963 u ndërtua reparti për prodhimin e yndyrave të ngurta me origjinë bimore. Më 1970 ndërtohet depoja për magazinimin e lulediellit me kapacitet prej 9,000 tonësh. Krahas ndërtimit të kapaciteteve të reja, bëhet edhe rikonstruktimi dhe modernizimi i procesit të prodhimit. Fabrika e vajit zhvillohet edhe më tej dhe arrin një kapacitet prej 11,000 tonë shishe të mbushura dhe të paketuara. Ishin të punësuar qindra punëtorë dhe prodhoheshin tonelata të tërë vaj bimor dhe margarinë me cilësi të mirë. Pas riorganizimeve, Fabrika e Vajit vendoset në kuadër të kombinatit bujqësor industrial “Milan Zeçar”. Pas vitit 1999 kaloi në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Në dhjetor të vitit 2005 ndërmarrja u privatizua. (Xhemajl Fejzullahu)

FABRIKA METALIKE “IMKOS”, KAMENICË. E themeluar në vitin 1950, në programin

e punës kishte këto prodhime: dyer dhe dritare metalike, rrethoja dhe konstruksione metalike, mbuloja me llamarinë etj. Fillimisht kishte të punësuar rreth 100 punëtorë. Më 1974 riorganizohet dhe bëhet organizatë e XIM "Strezocit", për të cilën kryente mirëmbajtjen e makinerive. Më 1983 bëhet organizatë e punës së bashkuar me emrin "Imkos". Vijat teknologjike të prodhimit dhe të shërbimeve mundësonin përpunimin e metaleve dhe prodhimin e artikujve të cilësisë së lartë: kioskave, garazheve montuese e demontuese të automjeteve, mbuloja nga konstruksionet e çeliktë, gërshtë kanapësh, fisnikërimin e metaleve me lidhje zinku, vegla bujqësore, prodhimin e ambalazheve të metalta për Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë, si dhe ofronte shërbime për remonte në termocentralet në Kosovë dhe vendet e tjera të ish-Jugosllavisë. Pas përfundimit të luftës, "Imkos" rifilloi aktivitetet afariste dhe kishte të punësuar rreth 50 punëtorë. Në vitin 2003 kjo fabrikë u privatizua. (Hysni Osmani)

FABRIKA PËR PËRPUNIMIN E MBETJEVE TË PLUMBIT, ZVEÇAN. Fabrika është ndërtuar në vitin 1980 sipas licencës dhe teknologjisë së kompanisë së njohur italiane "Tonolli". Veprimtaria themelore e fabrikës ishte përpunimi i mbetjeve të akumulatorëve të vjetër të plumbit. Fabrika prodhonte legurat e plumb-antimonit (Pb-Sb) dhe llojeve të plastikës. Aftësia e fabrikës ishte përpunimi i rreth 20,000 tonë në vit akumulatorë të vjetër të plumbit, ose prodhimi i rreth 14,000 tonë legura të Pb-Sb dhe 2,000 tonë të plastikës. Sasia e prodhimit ishte e varur nga mundësitë e furnizimit me mbetje të plumbit dhe të akumulatorëve. Fabrika ishte ndotës i madh i mjedisit. (Asllan Vitaku)

FABRIKA PËR PËRPUNIMIN E METALEVE TË ÇMUESHME "FAMIPA", PRIZREN. U themelua në mbështetje të traditës që kishte Prizreni në punimet e filigranit dhe në përpunimin e arit dhe të argjendit. Përpunimi kimik i argjendit dhe i arit filloi në vitin 1974, kur "Famipa" u integrua në kombinatin "Trepça". Në këtë mënyrë, eksporti i argjendit në bllok u zëvendësua me prodhime shumëfish të përpunuara e të kultivuara. Fabrika "Famipa" në programet e veta të prodhimeve kishte artikuj të ndryshëm: materiale elektrokontakti,

artikuj stolish dhe bizhuterish, stoli argjendi dhe ari, gjysmëfabrikate në bazë argjendi, legura me bazë argjendi për kallajisje dhe gërshtë, garnitura manekini dhe thika. Në "Famipa" për prodhimin e materialeve të elektrokontakteve nga argjendi (me përmbajtje mesatare 70%) janë harxhuar mesatarisht 35 - 60 tonë argjend në vit. Sipas planit 1981-1985 fabrika kishte paraparë të prodhojë mesatarisht 3.5 - 4.25 tonë stoli bizhuterie, të punuara nga argjendi dhe ari. Në vitin 1981 brenda një muaji mesatarisht finalizonte 10-20 kg ar dhe rreth 1,000 kg argjend. Meqë aftësitë prodhuese të "Famipës" ishin shumë më të mëdha, sasia e arit nga metalurgjia e "Trepçës" (mesatarisht 255 kg në vit) nuk mjaftonte për kapacitetet finalizuese, kështu që një sasi e arit blihej në Bor (Serbi). Kjo fabrikë u privatizua në vitin 2006. (Minir Dushi)

FABRIKA E AMORTIZATORËVE, PRISHTINË. U themelua në vitin 1965 për prodhimin e amortizatorëve hidraulikë. Fabrika ishte unike në Ballkan dhe, me qëllim të përcjelljes së të arriturave në fushën e konstruktimit dhe dizajnit të amortizatorëve, u pajis me makineri bashkëkohore, të dedikuara për prodhim në seri dhe në masë. Në sipërfaqen prodhuese prej më shumë se 15,000 m² u vendosën makina dhe pajisje nga Gjermania, Zvicra dhe Franca, të cilat i plotësonin të gjitha kriteret tekniko-teknologjike të kohës. Në vitet '80 në këtë fabrikë prodhoheshin rreth 4 milionë njësi në vit. Në programin e prodhimeve të fabrikës zinin vend amortizatorët për automobila (vetura, autobusë dhe kamionë), si dhe amortizatorët e lavtriçeve dhe pjesët për centrifuga. Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë njihej edhe si qendër e zhvillimit të inxhinierisë mekanike dhe metalpërpunuese, sepse në të u punësuan një numër i madh i inxhinierëve dhe i teknikëve të makinerisë. Njëkohësisht kjo fabrikë shërbeu edhe si qendër e aftësitimit profesional dhe shkencor të inxhinierëve, duke iu mundësuar punë praktike dhe eksperimentale për shumë tema të diplomave, të magistraturave dhe tezave të doktoratave. Në vitin 2010 u privatizua. (Hysni Osmani)

FABRIKA E VEGLAVE, FERIZAJ. E themeluar në vitin 1965, ishte e dedikuar për prodhimin e veglave të ndryshme dhe aparateve elektrike. Në periudhën e punës së

suksesshme kishte mbi 400 punëtorë. Falë përvojës së kuadrit dhe pajisjeve bashkëkohore, fabrika arriti zbatimin e suksesshëm të metodave të avancuara tekniko-teknologjike. Fabrika ka byronë përkatëse, e cila merret me konstruktimin e veglave sipas porosisë, si dhe linjën teknologjike me makina bashkëkohore konvencionale dhe me dirigjim kompjuterik. Ka edhe makina për përpunim me prerje, përpunim me deformim plastik dhe për përpunim termik dhe kimik-termik. Programi prodhues i fabrikës është fleksibël. Prodhoen vegla për përpunim të materialeve polimere, vegla për derdhjen e metaleve me ngjyrë, vegla për përpunim me deformim në të ftohtë dhe në të nxehtë, vegla progresive, vegla për ekstrudim, vegla për injektim etj. Më 2006 fabrika u privatizua dhe mori emrin “Fabrika e veglave plus aparateve elektrike Sh.p.k”. Është e certifikuar sipas standardeve ISO 9001-2008 dhe të gjitha produktet janë të cilësisë së lartë. (Hysni Osmani)

FABRIKAT E LËNGJEVE. Pas vitit 2000, në Kosovë industria e prodhimit të lëngjeve shënoi një rritje të shpejtë. Kjo ndodhi për shkak se për këtë veprimtari nevojiten investime të vogla. Lëngjet e prodhuara zakonisht janë natyrale, por mund të jenë edhe të gazuara. Kapaciteti i prodhimit të lëngjeve është në rritje, për shkak të konsumimit të tyre të vazhdueshëm. Shumica e prodhuesve të lëngjeve, përveç shitjes në tregun vendor, prodhimet e tyre i eksportojnë edhe jashtë vendit. Të gjitha fabrikat e lëngjeve si lëndë të parë shfrytëzojnë koncentratet e ndryshme të importuara nga shtetet e tjera. Koncentrati i nevojshëm zakonisht përzihet me ujë në raporte të caktuara, si dhe i shtohen shtesa të tjera, veçanërisht sheqer ose zëvendësues të tij. Koncentrati i importuar iu nënshtrohet kontrollimeve laboratorike për të përcaktuar përbërjen kimike dhe cilësinë e paraparë me normat ligjore. Rol të rëndësishëm në prodhimin e lëngjeve luan edhe cilësia e ujit të përdorur, i cili duhet t'i plotësojë normat e parapara me ligje. Fabrikat më të mëdha për prodhimin e lëngjeve në Kosovë janë: “Labion” (Podujevë), “Fruti” (Prizren), “Devolli” (Istog), “Vjosa” (Lukar), “Fluidi” (Gjilan), “Frutex” (Suharekë), “Frutomania” (Gjilan), “Bibita” (Pejë) dhe “BBF Compan” (Ferizaj). (Shefqet Rashani)

FABRIKAT E PËRPUNIMIT TË GRURIT.

Kultivimi i grurit në Kosovë, në vitet e shkuara përfshinte një sipërfaqe prej rreth 100,000 ha, përkatësisht 30-35% të sipërfaqeve me drithëra, ndërsa në kohë më të reja gruri mbillet në gjithsej 70,000 ha. Në vitet '80 rendimentet e grurit silleshin rreth 30 ku/ha. Kultivimi i grurit është më i përhapur në Rrafshin e Kosovës, në fushën e Drenicës, të Llapit, të Anamoravës dhe të Dukagjinit. Në vitet '80 prodhoheshin 250,000 tonë në vit, që plotësonin rreth 65% të nevojave të popullsisë në Kosovë. Aktualisht, rendimenti mesatar i grurit në Kosovë është 4.6 t/ha. Për përpunimin e grurit në Kosovë funksionojnë 101 fabrika, aftësia përpunuese e të cilave është 6,471 tonë në ditë, ndërsa ajo vjetore 1,760,112 tonë. Ndërkaq, aktualisht janë aktive 60 fabrika, aftësia prodhuese e të cilave sillet 5,056 tonë në ditë, përkatësisht 1,375,232 tonë në vit. Një aftësi e tillë prodhuese mund t'i plotësojë nevojat për një popullsi prej mbi 7 milionë banorësh. Ndërkaq, aftësia e depove për magazinimin e miellit është 42,700 tonë në mbetje, kurse aftësia për magazinimin-ruajtjen e grurit sillet rreth 184,234 tonë në mbetje për të gjitha fabrikat e përpunimit (101), ndërsa për ato aktive (60) është 266,740 tonë për një mbetje. Aftësitë përpunuese teknike të fabrikave janë të ndryshme, të cilat sillen 60-600 tonë në ditë. Në Kosovë punon fabrika për përpunimin e farës së grurit, “Agro-Elita” në Klinë, e cila ka aftësi të mjaftueshme për përpunimin e farës së grurit të prodhuar në Kosovë. Fabrikat më të mëdha të përpunimit të grurit gjenden në Fushë-Kosovë, Xërxë dhe Pejë. (Alush Musaj).

FABRIKAT E PËRPUNIMI TË QUMËSHITIT.

Përpunimi i qumështit në Kosovë ka filluar në vitet '90 të shekullit të kaluar, por me teknologji dhe aftësi të ulët, kryesisht për nevoja vendore të komunitetit. Pas vitit 2000, numri i fabrikave të qumështit u rrit, si kërkesë e kohës dhe e përkrahjes nga autoritetet vendore dhe ndërkombëtare. Ato u krijuan dhe u miratuan sipas ligjit për veterinarinë (2004/21, UA), ndërsa me aprovimin e ligjit për ushqimin (03/1-016) dhe rregullimin e pakos higjienike u plotësua edhe më shumë kuadri ligjor për aprovimin e tyre. Deri më tani janë licencuar nga autoritetet kompetente 45 fabrika për përpunimin e qumështit, nga të cilat shumica janë në gjendje pune, por me aftësi më të vogël



REPART I PRODHIMIT NË NJË FABRIKË TË QUMËSHITIT

prodhuese nga ajo e instaluar. Mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve në këtë fushë e bën Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë. Ndonëse tregu i Kosovës është i furnizuar mirë me qumësht vendor, nevojat e Kosovës mbulohen nga importi me rreth 60%, kryesisht me qumësht të sterilizuar në temperaturë ultra të lartë, jogurt, kos frutash, gjalpë, djathë të bardhë dhe kaçkavall. Rreth 80% e importit të këtyre produkteve vjen nga BE-ja, kryesisht nga Hungaria, Sllovenia, Gjermania dhe shtetet e rajonit. (Alush Musaj)

FABRIKAT E TULLAVE NË KOSOVË. Kosova ka pasur 7 fabrika të tullave, nga të cilat aktualisht janë në funksion 6 sosh.

Fabrika e Tullave dhe e Tjegullave në Gjakovë (1922) ishte pjesë e ndërmarrjes shoqërore "Dukagjini", e cila prodhonte tulla, blloqe giter dhe tjegulla. Në vitin 2006 fabrika privatizohet dhe fabrika e re "NIKI-S" ka të punësuar 670 punëtorë dhe aktualisht është ndërmarrja më e madhe në Gjakovë. Në vitet 2006-2010 fabrika e re trefishoi prodhimin. Vendburimi i argjilës për fabrikimin e tjegullave dhe blloqeve ndër më cilësoret ndodhet në periferi të Gjakovës, në Kodrën e Çabratit, me rreth 3,8 milionë m³.

Fabrika e tullave në Landovicë-Prizren (1932) ishte pjesë e ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku", që kishte 600 të punësuar. Pas privatizimit (2006) formohet ndërmarrja e re me tri njësi prodhuese: tulla të plota, blloqe dhe blloqe giter. Rreth 95% të prodhimit e plasojnë në tregun e Kosovës. Rezervat e argjilës mjaft cilësore sillen rreth 2,6 milionë m³.

Fabrika e tullave "Cigllana" në Kamenicë (1945). Në vitin 1977 u integrua me ndërmarrjen "Gragjevina" të Kamenicës. Me tullat e pro-

dhuara furnizonte Kamenicën dhe Gjilanin. Në vitin 2008 kjo fabrikë prodhonte 10,000 njësi FN blloqe në ditë. Rezervat e argjilës janë 1, 3 milionë m³, që ndodhen në Kodrën e Toponicës. *Fabrika e tullave "Kosova" në Prishtinë* (1947). Në vitin 1975 zgjeron aftësinë prodhuese. Në vitet 2002-2003 rinovohet dhe modernizohet nga partneri italian dhe u emërtua "Ital-Kosova". Në vitin 2006 fabrika u mbyll. Vendburimi i argjilës që shfrytëzohet ndodhet në Bërnice të Poshtme, 2 km larg fabrikës, ku rezervat janë rreth 4,3 milionë m³.

Fabrika e tullave "Ringov" në Pejë (1947). Deri në vitin 1989 ishte në kuadër të një kompanie ndërtimore me 200 punëtorë. Nga ajo kohë ajo u pavarësua si ndërmarrje shoqërore. Në vitin 2001 punësonte 81 punëtorë dhe shfrytëzonte 50% të aftësisë prodhuese, e cila ishte 10 milionë njësi blloqe në vit të formatit 19x20x30.

Fabrika e tullave "Mustafë Goga" në Ferizaj ishte pjesë e ndërmarrjes ndërtimore "Trajko Grkoviq". Në afërsi të Ferizajt ndodhet vendburimi i argjilës në fshatin Sojevë, 6 km larg qytetit. Rezervat e këtij vendburimi janë rreth 2,5 milionë m³.

Fabrika e tullave "8 Nëntori" në Podujevë. Ka prodhuar giter blloqe G-5. Fabrika u riparua plotësisht në vitin 1992. Pas vitit 1999 u emërtua "19 Qershori". Në vitet 1999-2000 u riparua dhe u modernizua sërish, me ndihmën e Agjencisë Europiane për Rindërtim. Ka të punësuar 112 punëtorë, me aftësi prodhuese 7,6 milionë njësi G-5 në vit. (Fetah Jagxhiu).

FABRIKAT PËR PËRPUNIMIN E RRUSHIT.

Kultivimi i rrushit dhe prodhimi i verërave në Kosovë ka një traditë të gjatë. Klima kontinentale dhe lartësia mbidetare (300-400 m) e vreshtave është shumë e përshtatshme për kultivimin e rrushit me cilësi të lartë. Në Kosovë janë më shumë se 200 ditë me diell në vit që janë të mjaftueshme që vendi ynë të jetë në të njëjtin nivel me disa rajone të njohura për prodhimin e verërave. Prodhimi vendor i verërave në Kosovë ishte i zhvilluar në shkallë të gjerë. Industria e prodhimit të verërave e arriti shkallën më të lartë në vitin 1989. Asokohe Kosova kishte 9,000 ha vreshta, prej të cilave furnizoheshin fabrikat e verërave dhe të përpunimit të rrushit: "Ereniku" në Gjakovë, "Agrokosova" në Suharekë, ndërmarrja bujqësore industriale në Krushë të Vogël dhe ndërmarrja bujqësore industriale në Rahovec.

Pas luftës së vitit 1999 punon vetëm fabrika "Stone Castle" në Rahovec. (Alush Musaj).

FABRKA E TEKSTILIT "DRATEKS", DRAGASH. E themeluar në vitin 1982, fabrika prodhonte tjerr nga leshi dhe fibra sintetike. Në këtë fabrikë u punua edhe tjerri efektiv, i cili u përdor për prodhimin e perdeve. Fabrika e ndërtuar në qytetin e Dragashit kap një sipërfaqe prej 17,400 m². Ishte e pajisur me makina nga Gjermania, Zvicra, Italia dhe nga vende të ish-Jugosllavisë, të cilat formonin linjat përkatëse teknologjike. Fabrika u privatizua në vitin 2005 dhe në vitin 2008, në objektin e ish-industrisë së tekstilit "Dratex" kompania turke "Rematex" filloi prodhimin me rreth 30 punëtorë. Ndërkohë, numri i punëtorëve ka arritur në mbi 300. Tjerrtorja "Remateks" prodhon tjerr cilësor në një sasi prej 120 tonësh në muaj, me synimin që aftësia e prodhimit të rritet deri në 150 tonë tjerr, duke e zgjeruar fabrikën në ato pjesë që ende mbahen të pashfrytëzuara. Prodhimet e fabrikës "Remateks" i dedikohen kryesisht eksportit, ndërsa lënda e parë sigurohet nga Spanja dhe Turqia (Musa Rizaj).

FAFOSI. Vendbanim fushor parahistorik i kulturës së Vinçës. Gjendej te Mitrovica, pranë lumit Sitnicë, në afërsi të fabrikës së fosfateve, prej nga e mori emrin (1, 213 m²). Vendbanimi përbëhet nga dy shtresa banimi, më i hershmi i takon neolitit të vonë (Fafosi I) dhe tjetri eneolitit të hershëm (Fafosi II). Fafosi Ia-b (Vinça-Tordosh) karakterizohet me banesa gjysmë të thelluara në tokë dhe është i njëkohshëm me horizontin e parë të vjetër të Tjerrtores së Prishtinës dhe horizontit të Vinçës në lokalitetin Zhitkoc-Karagaç. Qeramika riprodhon atë të Vinçës, me forma kryesisht bikonike gri të errët ose të zezë e të kuqe tullë dhe me dekor me incezime me shirita të gropëzuar apo të pikturuar me pastë të kuqe që fshihet. Fafosi II (Vinça-Plloçnik) përmban gjurmë të shkrirjes së bakrit. Në këtë fazë paraqiten banesa drejtkëndore dhe vetë faza korrespondon me horizontin e dytë të Tjerrtores dhe me atë të Vallaçit. Në Fafos janë zbuluar enë të qeramikës luksoze, figura antropomorfe dhe zoomorfe, altar kulturi me katër këmbë, kapak unikal prospomorf dhe vegla pune nga ashti dhe stralli, nga të cilat veçohen thikat dhe majë shigjetash me fletë rombike. (Haxhi Mehmetaj)

FAIT Piter (Pieter Cornelis Feith) (1945-). Diplomati holandez. Gjatë karrierës diplomatike shërbeu në misione diplomatike në Damask, Bon, Nju-Jork, Kartum e Bruksel. Ishte përfaqësues personal për ish-Jugosllavi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, lordit Robertson (1995-2001). Ishte zyrtari më i lartë ndërkombëtar në Kosovë në periudhën 2008-2012 në cilësi të Shefit të Zyrës Civile Ndërkombëtare (mekanizëm i paraparë me Pakon e Ahtisarit për mbikëqyrjen e implementimit) dhe njëkohësisht Përfaqësues i Posaçëm i Bashkimit Europian. Cilësia e dytë iu hoq nga funksioni në vitin 2011, ndërsa roli i tij si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar u shua pas vendimit të Grupit Drejtues Ndërkombëtar për dhënien fund mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. (Ilir Dugolli)

FAJN Xhon (John Fine V.A., Jr.) (1939-). Historian amerikan, profesor i historisë në Universitetin e Miçiganit. Lindi dhe u edukua në Princeton (Nju-Xhersi). Ndoqi studimet e larta për histori të Bizantit, të Ballkanit dhe të Rusisë mesjetare në Universitetin e Harvardit, ku edhe u diplomua. Studimet e doktoratës i përfundoi në vitin 1968 dhe një vit më vonë filloi të ligjëronte në Universitetin e Miçiganit. Veprat e tij më të njohura: "Kisha Boshnjake: një interpretim i ri: studim mbi Kishën boshnjake dhe vendin e saj në shtet dhe shoqëri nga shek. XIII deri në shek. XV" (1975, 2007), "Ballkani gjatë mesjetës së hershme: studim kritik nga shek. VI deri në fund të shek. XII" (1983), "Ballkani gjatë mesjetës së vonë: studim kritik nga fundi i shek. XII deri te pushtimet osmane" (1987), "Bosnjë-Hercegovina: një traditë e tradhtuar" (1994) etj. Në kuadër të dy monografive për historinë e hershme dhe atë të vonë të Ballkanit, gjenden të dhëna me interes edhe për ndriçimin e historisë së Kosovës gjatë mesjetës, si: krishterimi, dyndjet sllave, periudha bizantine, bullgare, nemanjide, për Betejën e Kosovës të vitit 1389, për principatat shqiptare, Gjergj Kastriotin-Skënderbeun etj. (Gjon Berisha)

FAKULTETI I MJEKËSISË, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës e themeluar në vitin 1969. Filloi me programin e mjekësisë së përgjithshme, ndërsa në vitin 1975 në kuadër të këtij fakulteti hapet edhe programi i stomatologjisë. Në vitet 1989-1999 punoi në



FAKULTETI I MJEKËSISË NË PRISHTINË

kushte të jashtëzakonshme. Në vitin 1996/97 në kuadër të këtij fakulteti u hap edhe seksioni e farmacisë, ndërsa në vitin 2001/02 edhe ai i fizioterapisë. Sipas Deklaratës së Bolonjës, Fakulteti i Mjekësisë ofron këto programe studimi: studime themelore trevjeçare për infermieri, mami, fizioterapi; studime themelore pesëvjeçare për farmaci; studime themelore gjashtëvjeçare për mjekësi të përgjithshme dhe stomatologji; studime të doktoratës për mjekësi, stomatologji dhe farmaci. Fakulteti i Mjekësisë ka 26 katedra: lëndët paramjekësore, fiziologji, anatomi, histologji, biokimi, anatomi patologjike, patologji, farmakologji, mjekësi ligjore, radilogji, mjekësi interne, infektologji, dermatovenerologji, neuropsikiatri, pediatri, kirurgji e përgjithshme, ortopedi me traumatologji, oftamologji, otorinolaringologji, gjinekologji, fiziatri, stomatologji, farmaci, fizioterapi, infermieri dhe mami. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTET I SHKENCAVE TË APLIKUARA TË BIZNESIT, PEJË. Institucion i arsimit të lartë në Pejë, i cili ishte njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, me mësim në gjuhën shqipe dhe boshnjake. Fillet i ka te Shkolla e Lartë Ekonomike-Komerciale, e cila në vitin akademik 2001/02 u reformua sipas Deklaratës së Bolonjës dhe u riemërua si Shkollë e Biznesit, ndërsa në vitin 2004 emërtohet Fakultet i Shkencave të Aplikuara të Biznesit. Nga viti 2007, studimet zhvillohen në tri departamente: administrim biznesi, kontabilitet dhe financa të biznesit dhe menaxhment, turizëm, hotelieri. Në vitin 2011 u inkuadrua në Universitetin e Pejës, i cili u hap ndërkohë. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI EKONOMIK, PRISHTINË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, themeluar në Prishtinë në vitin 1961, në kuadër të Fakultetit Ekonomik-Juridik. Në



FAKULTETI EKONOMIK DHE JURIDIK

vitin akademik 1971/72, Fakulteti Ekonomik-Juridik ndahet në dy fakultete: Ekonomik dhe Juridik. Në vitet 1991-1999 Fakulteti Ekonomik punoi në kushte të jashtëzakonshme. U reformua disa herë, sidomos pas vitit 1999, në harmoni me kërkesat e ekonomisë së tregut dhe me përvojën e universiteteve perëndimore. Në vitin 2001, përkatësisht 2007, në planet dhe programet mësimore bëhen ndryshime të thella, sipas Deklaratës së Bolonjës. Në vitin 2004 miratohen edhe planet mësimore për nivelin master në departamentet: financa dhe kontabilitet, menaxhment dhe informatikë, si dhe në atë ekonomik. Fakulteti Ekonomik ofron programe studimi për baçelor dhe master në këto drejtime: ekonomi, banka, financa dhe kontabilitet, menaxhment dhe informatikë, marketing dhe kontabilitet. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI FILOZOFIK, PRISHTINË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, i cili u themelua në Prishtinë në vitin 1960 dhe kishte këto katedra: të matematikës, të fizikës, të biologjisë, të kimisë, të gjuhës dhe letërsisë shqipe e të gjuhës serbokroate dhe letërsisë jugosllave. Në vitin 1961 u hapën edhe katedrat e gjuhës dhe letërsisë frënge, e gjuhës dhe e letërsisë angleze, e gjuhës dhe e letërsisë ruse, pasuar edhe nga katedra e orientalistikës dhe e turkologjisë. Në vitin 1962 u hapën edhe degët e historisë, gjeografisë dhe pedagogjisë. Në vitin 1971, nga Fakulteti Filozofik pavarësohet Fakulteti i Shkencave Matematike-



FAKULTETI FILOZOFIK I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Natyrore, ndërsa në vitin akademik 1972/73 në kuadër të tij hapet katedra e filozofisë dhe e sociologjisë. Në vitin 1989, nga Fakulteti Filozofik pavarësohet Fakulteti i Filologjisë. Nga vitit akademik 1991/92 deri në vitin 1999, Fakulteti Filozofik i organizoi studimet në gjuhën shqipe në shtëpi-shkolla, në kushte të jashtëzakonshme. Në vitin 2001 në Fakultetin Filozofik hapet departamenti i shkencave sociale me drejtimet: departamenti i shkencave politike dhe administratës publike, departamenti i psikologjisë, departamenti i etnologjisë, ndërsa departamenti filozofico-sociologji ndahet në departamente të veçantë: të sociologjisë dhe të filozofisë. Në vitin akademik 2001/02, në kuadër të departamentit të pedagogjisë hapet drejtimi i edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, ndërsa në vitin akademik 2006/07 hapet drejtimi pedagogji sociale, i cili në vitin akademik 2012/13 u shndërrua në departament të punës sociale. Në vitin akademik 2013/14, departamenti e pedagogjisë nga Fakulteti Filozofik kalon në Fakultetin e Edukimit. Fakulteti Filozofik ka këto departamente: të filozofisë, të historisë, të sociologjisë, të shkencave politike, të psikologjisë, të etnologjisë dhe të punës sociale. Në vitin 2002 edhe në këtë fakultet filloi reforma sipas Deklaratës së Bolonjës. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I ARTEVE, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, fillet e të cilit gjenden në seksionin e artit figurative dhe muzikor të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës (1958). Në vitin akademik 1973/74 u themelua Akademia e Artit Figurativ në Prishtinë. Në vitin akademik 1986/87 në kuadër të këtij fakulteti u themelua edhe



FAKULTETI I ARTEVE

dega e artit muzikor dhe Akademia e Arteve u shndërrua në Fakultet të Arteve. Në vitin akademik 1989/90 themelohet edhe dega e arteve dramatike. Nga vitit 2001 ky fakultet filloi punën për reformimin e studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës. Tani ka tri degë me nga disa drejtime: dega e arteve figurative, me drejtimet: pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn grafik dhe skenografi, dega e arteve muzikore, me drejtimet: kompozim, dirigjim, solokëndim, piano, instrumente me harqe, instrumente me frymë, pedagogji e përgjithshme muzikore, etnomuzikologji; dega e arteve dramatike, me drejtimet: aktrim, regji e teatrit, dramaturgji dhe regji filmi. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE I VETERINARISË, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, e themeluar në Prishtinë në vitin 1973. Pararendës të tij



FAKULTETI I BUJQËSISË DHE I VETERINARISË NË PRISHTINË

ishin Instituti për Hulumtime Bujqësore në Pejë (1949) dhe Shkolla e Lartë Bujqësore në Prishtinë (1960). Në vitin 1974 Fakulteti i Bujqësisë kishte dy seksione: lavërtari dhe

blegtori. Në vitin 1975 iu shtua edhe drejtimi i përgjithshëm. Në vitin 1981 në kuadër të këtij fakulteti u integruan: Instituti Bioteknik në Pejë, Instituti për Blegtori dhe Veterinari në Prishtinë, Instituti për Ekonomi dhe Zhvillim në Fushë Kosovë dhe Fidanishtja Bujqësore në Pejë. Në kuadër të reformave në vitin akademik 1988/89, 1995/96 dhe 2000/01, ndryshuan dhe u shtuan edhe drejtimet. Nga viti 2001 fillon me studime të reformuara sipas Deklaratës së Bolonjës. Në vitin akademik 2003/04 nisi punën Ferma Eksperimentale Didaktike, ndërsa në vitin akademik 2006/07 Fakulteti i Bujqësisë emërtohet Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë. Studimet themelore në këtë fakultet organizohen në këto programe studimi: lavërtari dhe perimtari, pemëtari dhe vreshtari, mbrojtje e bimëve, blegtori, agroekonomi dhe mjekësi veterinare, ndërsa studimet për master organizohen në lavërtari dhe perimtari, pemëtari dhe vreshtari, blegtori dhe agroekonomi. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I EDUKIMIT. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, themeluar në vitin 2002. Pararendës i tij ishte Fakulteti i Mësuesisë, themeluar në Prishtinë, më 1997. Në kuadër të



FAKULTETI I EDUKIMIT NË PRISHTINË

tij, në vitin 2004 u integruan të gjitha shkollat e larta pedagogjike, të cilat u shndërruan në qendra rajonale të Fakultetit të Edukimit: në Prishtinë, në Gjakovë, në Prizren dhe në Gjiçan. Përveç programit parashkollor dhe fillor, në vitin 2004 u miratuan planet mësimore edhe për tetë degë të mësimin lëndor: gjuhë shqipe e letërsi, gjuhë angleze e letërsi, matematikë-informatikë, teknologji-informatikë, fizikë-kimi, biologji-kimi, histori-edukim qytetar dhe gjeografi-edukim qytetar. Me reformën

e fundit, Fakulteti i Edukimit zhvillon tri programe studimi: edukim parashkollor, fillor dhe pedagogji, e cila kaloi në këtë fakultet në vitin akademik 2013/14. Zhvillon edhe programin për avancimin e kualifikimit të mësimdhënësve. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I FILOLOGJISË, PRISHTINË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës. U pavarësua nga Fakulteti Filozofik në vitin 1988. Fillet i ka të Shkolla e Lartë Pedagogjike



FAKULTETI I FILOLOGJISË

e Prishtinës (1958) dhe në Fakultetin Filozofik. Në këtë fakultet, në vitin akademik 1960/61 u hapën katedrat për gjuhë dhe letërsi shqipe, për gjuhë serbokroate dhe letërsi jugosllave. Pasuan edhe katedrat për gjuhë dhe letërsi angleze, për gjuhë e letërsi ruse, gjuhë e letërsi frënge dhe të orientalistikës. Në vitin 1989, në këtë fakultet hapet edhe dega e gjuhës turke, ndërsa në vitin 1992 edhe dega e gjuhës gjermane. Në vitet 1991-1999 Fakulteti i Filologjisë, me përjashtim të degëve të gjuhës dhe letërsisë jugosllave dhe të gjuhës e letërsisë ruse, punoi në kushte të jashtëzakonshme, për shkak të masave të dhunshme të pushtetit serb. Së fundi punon sipas modelit evropian të studimeve. Veprimtarinë arsimore-shkencore e zhvillon në këto degë: gjuhë shqipe dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi angleze, gjuhë dhe letërsi frënge, gjuhë dhe letërsi gjermane, gjuhë dhe letërsi turke, orientalistikë, letërsi e përgjithshme dhe krahasimtare, gazetari. Ofron studime për të tri shkallët e studimeve akademike, baçelor, master dhe doktoratë. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE DHE I TEKNOLOGJISË, MITROVICË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, e

themeluar në Mitrovicë në vitin akademik 1974/75, me emrin Fakulteti i Xehetarisë dhe i Metalurgjisë. Veprimtarinë e vet ky fakultet e zhvillon në katër departamente: departamenti i xehetarisë me drejtimet gjeoteknikë, xehetari, punime minerare dhe tunelet, inxhinieri e përgatitjes së lëndëve të para; departamenti i gjeologjisë me drejtimet: vendburimet e lëndëve të para minerale, hidrogeologji me gjeologji inxhinierike; departamenti i teknologjisë me drejtimet: inxhinieri kimike, inxhinieri e mbrojtjes së mjedisit, inxhinieri ushqimore; dhe departamenti për metalurgji dhe materiale me drejtimet: metalurgji, materiale, materiale metalike dhe materiale qeramike. U reformua sipas Deklaratës së Bolonjës. Në vitin 2011 Fakulteti i Xehetarisë dhe i Metalurgjisë në Mitrovicë riemërtohet në Fakultet i Gjeoshkencave dhe i Teknologjisë. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE, PRISHTINË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, e themeluar në Prishtinë në vitin 1988. Pararendës të tij ishin drejtimi i elektroteknikës në Shkollën e Lartë Teknike të Prishtinës (1961) dhe seksioni i elektronikës, që u hap në vitin akademik 1967/68 në Fakultetin Teknik në Prishtinë. Në vitin 1988, Fakulteti Teknik ndahet në tri fakultete, ndër të cilët ishte edhe Fakulteti e Elektronikës, me katër profile arsimore: sistemet elektroenergjetike, energjetika industriale, telekomunikacioni me informatikë dhe automatika me elektronikë. Në vitin 2001 ky fakultet filloi reformimin sipas Deklaratës së Bolonjës. Emrin e ndryshoi në vitin akademik 2004/05. Ofron programe studimi në këto drejtime: automatikë, elektronikë, elektroenergjetikë industriale, kompjuterikë, telekomunikacion dhe sisteme elektroenergjetike. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, fillet e të cilit gjenden te Shkolla e Lartë Teknike në Prishtinë (1961), përkatësisht në Fakultetin Teknik, themeluar në vitin 1965, i cili në vitin 1988 ndahet në tri fakultete: në Fakultetin e Elektroteknikës, Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe në Fakultetin e Makinerisë. Në vitin akademik 2001/02 Fakulteti i Makinerisë u transferua në Fakultet të



FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Inxhinierisë Mekanike me katër departamente: prodhim dhe automatizim, termoenergjetikë e termoteknikë, konstruksion e dizajn dhe komunikacion. Në vitin 2007 fakulteti miratoi plane të reja studimi për baçelor për të vijuar edhe me nivele të tjera të studimit. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE I SPORTIT, PRISHTINË.

Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, u themelua në Prishtinë në vitin 1979. Fillet i ka te dega e



FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT

edukatës fizike në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Që nga themelimi i tij, Fakulteti i Kulturës Fizike organizoi studime dyvjeçare për arsimtarë të kulturës fizike dhe studime katërvjeçare për mësimdhënës të kulturës fizike në shkolla të mesme. Në vitin 1991 profesorët dhe studentët shqiptarë largohen me dhunë nga objektet e këtij institucioni, por veprimtarinë e tyre e vazhduan në objekte private deri në vitin 1999. Në vitin 2001/02 u reformua sipas Deklaratës së Bolonjës. Përveç

punës mësimore, ky fakultet merret edhe me veprimtari të tjera sportive. Në kuadër të tij funksionojnë edhe dy ekipe sportive: klubi i volejbollit (femrat) dhe klubi i atletikës. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE I ARKITEKTURËS, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, e themeluar në Prishtinë në vitin 1988. Fillet i ka te drejtimi i



FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE I ARKITEKTURËS

ndërtimtarisë në Shkollën e Lartë Teknikë të Prishtinës (1961), përkatësisht në Fakultetin Teknik të Prishtinës (1965), me seksionin e ndërtimtarisë. Në vitin 1977 në këtë fakultet hapet edhe seksioni i arkitekturës. Në vitin 1988 Fakulteti Teknik u nda në tri fakultete, ndër të cilët ishte edhe Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës. Në vitet '90 punoi në kushte të jashtëzakonshme. Nga viti 2001 iu nënshtrua reformave sipas Deklaratës së Bolonjës. Ka këto seksione me drejtime përkatëse: seksioni i ndërtimtarisë me drejtimin e konstruksioneve dhe atë hidroteknik; seksioni i arkitekturës me drejtimet: planifikim dhe menaxhim urban, si dhe me atë të projekteve. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME, PRISHTINË. U themelua në vitin 1992. Është fakulteti i parë për studimet islame në gjuhën shqipe. Hapja e këtij fakulteti u konsiderua si zgjidhje e përshtatshme për të studiuar dhe kultivuar në Kosovë islamin tradicional, kundrejt prurjeve të ndryshme ideologjike nga kjo fushë e dijes dhe e përkushtimit fetar. Studimet në këtë fakultet zgjasin katër vite akademike, përkatësisht tetë semestra. Në Fakultetin e Studimeve Islame mësohen kryesisht lëndë fetare, por edhe bashkëkohore.



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME

Aty i ndjekin studimet studentë të rregullt dhe me korrespondencë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare, si: Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe nga diaspora. Fakulteti nisi punën në ish-objektin e Medresesë "Alaudin", ndërsa nga viti 2011 punon në godinë të re, me kushte më të mira. Deri në fund të vitin akademik 2014/15 në Fakultetin e Studimeve Islame kanë diplomuar 321 studentë. (Qemajl Morina)

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE (FSHMN), PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, i cili u themelua në Prishtinë në vitin shkollor



FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

1971/72, mbështetur në drejtimet e shkencave natyrore-matematikore në Fakultetin Filozofik. Fillimisht kishte tri seksione: të kimisë, të fizikës dhe të biologjisë. Në vitin akademik 1962/63 u themelua edhe seksioni i gjeografisë. Me vendosjen e masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës, studimet në gjuhën shqipe në këtë fakultet prej vitit 1991-1999 u

zhvilluan në kushte të jashtëzakonshme. Në vitin akademik 1995/96 në FSHMN u bë një riorganizim i katedrave në drejtime mësimore dhe shkencore inxhinierike. Në vitin akademik 2001/02 filluan studimet në harmoni me Deklaratën e Bolonjës. Në departamentet ekzistuese u bënë ndryshime në kuadër të studimeve баçelor, duke krijuar drejtime të reja. Në departamentin e matematikës studiohet në drejtimet: arsimor, i përgjithshëm dhe drejtimi i shkencave kompjuterike. Departamentet e fizikës, përkatësisht i kimisë, kanë nga dy drejtime: arsimor dhe inxhinierik. Departamenti i biologjisë ka dy drejtime: arsimor dhe ekologjik. Departamenti i gjeografisë, gjithashtu, ka dy drejtime; arsimor dhe aplikativ. FSHMN-ja ofron programe studimi për баçelor, master dhe doktoratë. (Ganimete Kulinxha)

FAKULTETI JURIDIK, PRISHTINË. Njësi akademike e Universitetit të Prishtinës, i cili u themelua në Prishtinë, në vitin 1961, në kuadër të Fakultetit Ekonomik-Juridik. Në Fakultetin Juridik, fillimisht kishte dy shkallë studimi: dyvjeçare dhe katërvjeçare. Në vitin akademik 1971/72, Fakulteti Ekonomik-Juridik ndahet në dy fakultete: Ekonomik dhe Juridik, me seksione të ndryshme. Për shkak të masave të dhunshme, Fakulteti Juridik në vitet 1991-1999 e zhvilloi veprimtarinë e vet në kushte të jashtëzakonshme. Në vitin 2001 senati i Universitetit të Prishtinës miratoi planet e studimit për баçelor, sipas Deklaratës së Bolonjës, ndërsa në vitin 2004 miratohen planet mësimore për studime në të gjitha drejtimet: të kushtetutës dhe administrimit, të drejtimit civil, të drejtimit penal, të drejtimit ndërkombëtar dhe të drejtimit financiar. Fakulteti Juridik ofron studime për баçelor, master dhe doktoratë. (Ganimete Kulinxha)

FALIMENTIMI. Quhet situata në të cilën një person juridik nuk është në pozitë për të paguar detyrimet e veta ndaj palëve të treta brenda një afati të caktuar kohor, si pasojë e së cilës bëhet riorganizimi ose likuidimi i personit juridik. Në Kosovë nuk rregullohet në mënyrë specifike falimentimi i personave fizikë, ndërkaq falimentimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore rregullohet me ligj të veçantë. Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit të një personi juridik mund të nisët nga debitori, kreditori apo një grup

kreditorësh. Sipas ligjeve të Kosovës, debitori e fillon procedurën e falimentimit në rastet kur debitori nuk është në gjendje të paguajë një borxh të caktuar në vlerë prej së paku 5,000 eurosh për një periudhë më të gjatë se 60 ditë pas arritjes së borxhit për pagesë dhe, përgjithësisht, nuk është në gjendje të paguajë detyrimet ndaj palëve të treta në kohën kur detyrimet arrijnë për pagesë. Për kreditorët apo grupin e kreditorëve pamundësia e pagesës është 2,000 euro. Me ligjet e Kosovës procedura e falimentimit udhëhiqet nga një administrator i emëruar nga gjykata kompetente dhe mund të rezultojë me riorganizimin apo likuidimin e personit juridik që i është nënshtruar procedurës së falimentimit. (Dastid Pallaska)

FALMERAJER Jakob (Jacob Fallmeyer) (1790-1861). Gazetar, politikan, historian, udhëpërshkrues tirolez. Njihet për teoritë kundërthënëse lidhur me origjinën e grekëve. Shkroi edhe për arvanitasit. Kryengritjen për pavarësinë e Greqisë e quajti shqiptare dhe jo greke. Mbronte teorinë se grekët e lashtë janë zëvendësuar me kohë nga sllavët, teori e ngjashme me të Martin Likut. Është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Bavarisë dhe ka ligjëruar në këtë akademi për shqiptarizimin e popullatës së Atikës. Bashkëpunonte me gazetën "Algemeine Zeitung". Më 1836 botoi e veprën "Historia e Gadishullit të Moresë gjatë mesjetës" (Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters). Pjesa e dytë e librit mban titullin: Morea, e shkatërruar nga luftërat e brendshme të frankëve e të bizantinëve dhe e kapluar nga kolonët shqiptarë, pushtohet në fund nga turqit; pjesa e parë e botuar më 1857 dhe pjesa e dytë e botuar më 1860-61. Ka shkruar edhe për elementet shqiptare në Greqi. (Bardh Rugova)

FAMILJA E MADHE SHQIPTARE. Bashkësi familjare që kanë funksionuar për një kohë të gjatë në hapësirat shqiptare. Ato kishin pasurinë e përbashkët, jetonin dhe punonin së bashku dhe i konsumonin bashkërisht frytet e punës së tyre. Rendi familjar dhe mënyra e jetesës ishte patriarkale, me organizim mbi bazën e respektimit të rregullave të përcaktuara dhe të hierarkisë gjinore dhe të moshës brenda familjes. Familja e madhe shqiptare historikisht mbështetej në disa parime: pjesëtarët e saj jetonin nën një kulm, kishin zotin dhe

zonjën e shtëpisë, kishin për qëllim shtimin e anëtarëve të familjes nëpërmjet martesës, lindjes së fëmijëve etj. Familjet patriarkale shqiptare i rregullonin marrëdhëniet e tyre me komunitetin kryesisht duke u mbështetur në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Kjo formë e organizimit familjar te shqiptarët përmendet që në mesjetë: familja e njohur e bujare e dukagjinase përmendet qysh më 1281, si familje e madhe patriarkale. Familjet e mëdha quheshin ndryshe edhe “shtëpia e fortë”. Organizimi i brendshëm i familjes së madhe në Kosovë ishte i ngjashëm me atë që kanë pasur dikur familjet e mëdha ndër popuj të tjerë të Ballkanit. Familje të këtilla ka pasur në Pejë, Gjakovë, Deçan, Voksh, Prizren, Podrimë, Opojë, Drenicë etj. Përveç në Rrafshin e Dukagjinit, familjet e mëdha patriarkale kanë ekzistuar edhe në Rrafshin e Kosovës. (Angjelina Hamza)

FAMILJA E NDARË MIGRUESE. Tip i familjes që krijohet nga lëvizjet migruese të popullsisë, sidomos me emigrimin e ushqyesit, personit kyç apo bartësit kryesor të aktiviteteve ekonomike dhe të sigurisë së saj. Për këtë tip të familjes nuk është shkruar shumë jo vetëm në Kosovë, por as në qarqet shkencore të rajonit përgjithësisht. Mungesa e babait në familje me premisa të qarta patriarkale detyrimisht e ndërron karakterin e saj, duke bartur kompetenca dhe përgjegjësi mbi nënën, së cilës, sidomos në Kosovë historikisht nuk i takonin. Kosova, si edhe vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë, është përfshirë nga lëvizje të kohëpaskohshme migruese të popullsisë në distanca hapësinore, kohëzgjatje, intensitet të karakterit të ndryshëm. Këto rrethana kanë ndikuar në krijimin e familjeve të bilocuara (dyvendore) migruese. Fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70 të shekullit të kaluar shënojnë masivizimin e dukurisë së lëvizjeve, sidomos të ushqyesve të familjeve, fillimisht nga viset rurale nëpër qendra urbane të Kosovës, si migrantë ditorë, e më vonë në “punë të përkohshme jashtë vendit”. Këto lëvizje ndikuan edhe në fillimin e procesin të shkapërderdhjes së familjeve të mëdha, karakteristike për Kosovën. Interesi shkencor për familjen e bilouar kryesisht përqendrohet në pozitën e fëmijëve, përkujdesjen, edukimin dhe mbrojtjen e tyre në kontekstin e rrethanave të reja të ekonomizimit, të rreziqeve që i

kërcënojnë ata jashtë kontrollit të pushtetit autoritar të babait dhe fuqizimin e autoritetit të nënës. (Anton K. Berishaj)

FAMILJA TRADICIONALE. Formë e organizimit familjar, e mbështetur mbi normat e traditës së të drejtës zakonore. Numri i anëtarëve të familjes mund të jetë indikator i premisave tradicionale në familje. Familja tradicionale shquhet me izolim nga struktura e përgjithshme shoqërore, si bashkësi punuese egalitare me pronë kolektive si raport dominues të pronësisë. Në këto bashkësi udhëheq individuali me pjesëmarrjen e kolektivit, rendi patriarkal në familje shprehet në dominimin e mashkullit, ndërsa vlerë qenësore dhe tipar kryesor i këtyre bashkësive është harmonia. Duke pasur parasysh faktin se këto familje bëjnë jetën e tyre jashtë trendeve politike dhe shoqërore, organizimi dhe strukturimi i saj ndodh brendapërbrenda strukturës farefisnore. Jeta në rrethanat e anarkisë shoqërore dhe politike i rrezikon të gjithë anëtarët, prandaj familja është ajo që duhet t'i mbrojtë anëtarët e saj me dozë të theksuar të autoritarizmit. Siguria matej me numrin e pushkëve, me pasurinë e sipërfaqeve të tokës së bukës dhe me numrin e bagëtive të imëta dhe të trasha. Harmonia në familje buron nga respektimi dhe lojaliteti ndaj të zotit të shtëpisë dhe të moshuarve, si dhe nga nënshtrimi i detyrueshëm ndaj kërkesave të grupit. Me një fjalë, familja synonte vetëmjaftueshmërinë, pasi ishin të shpeshta situatat kur familja detyrohej të mbrohej edhe nga fqinjët e vet. Në anën tjetër, familja duhej të ruante edhe nivelin e lartë të hapjes dhe bashkëpunimit me strukturat farefisnore, sepse pikërisht kjo strukturë ia përcaktonte edhe vendin dhe prestigjin në hierarkinë shoqërore të vendit. (Anton K. Berishaj)

FAMILJET FEUDALE RASIANE. Familje feudale që sunduan në pjesë të ndryshme të Ballkanit gjatë shek. XIV, gjatë dhe pas rënies së Perandorisë së Dushanit.

Brankoviqët. Emri i familjes rrjedh nga paraardhësi Branko Mladenoviq, i cili ishte sevastokrator, një titull i lartë në Perandorinë Bizantine. Në skenën historike u paraqitën në vitet '30 të shek. XIV. Autoriteti i kësaj familjeje filloi të rritej pas vdekjes së Dushanit. Në prag të Betejës së Kosovës (1389), Vuk Brankoviqi ishte njëri ndër feudalët më të fuqishëm rasianë. Pas disfatës në Betejën

e Kosovës (1389), Brankoviçët pranojnë vasalitetin osman. Pas rënies së Despotatit të Rashës nën sundimin osman (1459), si familje u shpërngulën në pjesën jugore të Hungarisë, duke e pranuar vasalitetin e mbretit hungarez. Tradita popullore serbe dhe një pjesë e asaj ballkanike Vuk Brankoviçin e konsideron trashtar të Betejës së Kosovës. Kjo familje, përveç se ka lënë gjurmë në historinë mesjetare ballkanike, është njëra ndër më të trajtuarat në epikën popullore.

Lazareviçët. Familje fisnike mesjetare me origjinë nga Prilepci i rretheve të Novobërdës. Fillet e saj nuk janë të njohura mirë, por mendohet se themelues i dinastisë ishte Pribac Hrebelani (Grebelani), që kishte shërbyer si zyrtar në oborrin e Stefan Dushanit. Personaliteti më i njohur nga kjo familje është princi Lazar, prej nga e mori emrin edhe dinastia, Lazareviç. Lazari ishte njëra ndër figurat më të rëndësishme të mbetura në skenën politike të Rashës pas vdekjes së Dushanit (1355). Territori i tij shtrihej në një pjesë të madhe të Serbisë së sotme Lindore dhe kishte qendër Krushevcin. Lazari ishte udhëheqës i koalicionit ballkanik në Betejën e Parë të Kosovës (1389) kundër sulltan Muratit I. Vrasja e Lazarit në fushëbetejë shërbeu si shkas për krijimin e “mitit serb mbi Kosovën”, duke e shpallur edhe si “Car Lazari”, edhe pse burimet e kohës e njohin me titullin shtetëror princ (knez).

Mërnjavçeviçët. Familje dhe dinasti që sunduan pjesë të Maqedonisë së sotme që në kohën e Dushanit. Dokumentet e kohës e nxjerrin Ugleshën si regjent të Trebinjës (1346) dhe despot në vitet '60 të atij shekulli. Ndërkaq, Vukashini u bë i njohur si zhupan i Prilepit (1350) dhe mbret në vitin 1365. Që të dy vdiqën në të njëjtën ditë në Betejën e Maricës (më 26 shtator 1371). Vukashini kishte lënë vajzën Olivera, e cila ishte martuar me Gjergj Balshën I, si dhe bijtë: Markun (Kraleviç Markon), Andrean, Dhimitrin e Ivanin. Selia e Markut ishte në Prilep, ndërsa Prizreni në kohën e tij kishte kaluar në duart e Balshajve. Ai vdiq në Betejën e Rovinës në Rumuni (1395), duke i ndihmuar osmanët në luftë kundër vojvodës së Vllahisë. Edhe pse gjatë jetës ishte më pak i njohur, epika gojore sllave e shpalli për njërin ndër heronjtë më të mëdhenj të sllavëve të jugut. (Qerim Dalipi)

FAMILJET ROMAKE NË KOSOVË. Në mesin e popullsisë së lirë që i përkisnin shtresës së patricëve romakë në Kosovën antike janë dëshmuar katër familje të mëdha romake, të cilat jetonin dhe vepronin apo kishin prona në Dardani. Familje të tilla ishin Papiria, Furi, Ponti dhe Quirini. Familja Papiria vinte nga fisi Papiria e Umbrisë (Itali), vendlindja edhe e perandorit Trajan, themeluesit të Ulpianës së Dardanisë (Graçanicë). Kjo familje është dëshmuar edhe në një “tabula ansata” prej mermeri, ku përmendet dekurioni P. Licinius Aelianus, pjesëtar i kësaj familjeje. Gjatë shek. II-III në Dardani jetuan dy familje senatoriale romake, Furi dhe Ponti. Familja Furi ishte pronare e latifondeve në rrethinat e Ulpianës dhe të Prizrenit, ndërsa familja Ponti njihet si familje senatoriale në Ulpianë, pronare e minierave dhe e latifondeve. Familja Ponti është dokumentuar mjaft nga mbishkrimet dedikuar skllëverve të liruar nga kjo familje. Familja Ponti dëshmohet dhe në mbishkrimin honorifik të Gamicus nga Agio Pnevma, jo larg qytetit Sirisë të Italisë, që ishte skllav i liruar nga familja Ponti dhe që identifikohet me degën senatoriale të Pontëve në Dardani. Monumenti epigrafik nga Smira (1988) dëshmon prezencën edhe të familjes së katërt fisnike nga Roma, të tribës Quirinus, anëtar i së cilës ngriti monumentin kushtuar Jupiterit, në të cilin gjendet dedikimi jo i zakonit, që tregon se i dedikohet Jupiterit romak dhe jo interpretimit vendës të tij (IOMN). Prezenca e familjeve fisnike nga Roma antike flet për rëndësinë dhe interesimin që zgjonte kjo pjesë e Dardanisë për shkak të pasurive të saj natyrore. (Arianit Buçinca)

FAMULLIA E PRIZRENIT. Është njëra ndër famullitë më të vjetra në trojet shqiptare. Data e saktë e themelimit nuk dihet, meqë themelimi i saj lidhet me organizimin e Kishës Katolike në Dardani në antike dhe themelimin e argjipeshkvisë, e cila paraqitet herë me seli në Prizren e herë me seli në Shkup. Rolin dhe rëndësinë e veçantë Famullia e Prizrenit e mori në kohën kur kulmoi procesi i islamizimit, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane. Nga kjo famulli janë dërguar në Romë shumë relacione të famullitarëve të saj, si i dom Gergur Mazrekut dhe të shumë vizitorëve apostolikë, imzot Marin Bicit, dom Pjetër Mazrekut, imzot Gjergj Bardhit

e deri te imzot Andrea Bogdanit dhe nipit të tij imzot Pjetër Bogdanit. Në burimet historike në Prizren përmenden dy kisha, që dëshmon se qyteti i Prizrenit ka pasur në vazhdimësi numër të konsiderueshëm besimtarësh. Aktualisht për besimtarët katolikë shërben katedralja e Zojës Ndhimëtare, e rindërtuar në rrënojat dhe pjesërisht me materialin e kishës së vjetër, në të njëjtin vend, në vitin 1870. Festa e famullisë festohet më 24 maj. Në kuadër të Famullisë së Prizrenit është edhe kisha në Grazhdanik, që u është kushtuar martirëve të parë të krishterimit nga Ulpiana antike, Shën Florit dhe Shën Laurit. (Pjetër Përgjoka)

FAMULLIA E SHËN GJON PAGËZUESIT, ZLLAKUQAN. Njësi e Ispeshkvisë së Kosovës, e themeluar në vitin 1897. Deri në këtë vit ishte në përbërje të Famullisë së Pejës. Themelimi i Famullisë së Zllakuqanit erdh si rezultat i Konkilit të Tretë Shqiptar të mbajtur në Shkodër në vitin 1895. Me ndihmat që u mblohdën në Austri, dy vjet më vonë u ndërtua një objekt i përbashkët, qela dhe kisha e vogël. Pajtor i Kishës dhe i Famullisë së Zllakuqanit është Shën Gjon Pagëzuesi, festa e të cilit kremtohet për çdo 24 qershor. Meshtarët që shërbyen në këtë famulli ishin figura të njohura të historisë dhe të kulturës kombëtare, si atë Lorenc Mazrreku, atë Shtjefën Gjeçovi, atë Engjëll Palaj, imzot Mark Sopi etj. Nga Shtjefën Gjeçovi, në vitin 1897, në qelën e kishës së Zllakuqanit u hap shkolla në gjuhën shqipe. Objekti i kishës së ndërtuar në vitin 1897 nuk i plotësonte nevojat e besimtarëve, kështu që me dekretin e imzot Lazër Mjedës, në vitin 1924 filloi ndërtimi i kishës së tanishme, ndërsa në vitin 1933 u bë bekimi i saj. Famullia e Zllakuqanit ishte më e madhja në Dioqezën Shkup-Prizren dhe si e tillë ka funksionuar deri në vitet '80 të shekullit të kaluar, kur prej saj formohen edhe dy famulli të reja, ajo e Klinës dhe e Budisalcit. (Pal Canaj)

FAMULLIA E SHËN JOZEFIT, STUBËLL E EPËRME. Si famulli e pavarur nga Letnica u themelua në vitin 1905, me famullitar dom Mikel Tarabulluzin. Në Stubëll u themelua kolegj-shkollë e parë shqipe, si shkollë e lartë (1584), ku mësohej filozofia e studioheshin klasikët. Kolegji punoi me ndërprerje deri më 1905, kur u njoh nga Austro-Hungaria, si shkollë e parë legale shqipe. Famullia ka kishën e vjetër të Shën Gjergjit, Kishën famullitare të

Shën Jozefit, Kishën e Shën Premtes - Anës (filiali Dunav, Gjilan). Festë kryesore e famullisë është Shën Jozefi (19 mars). Që nga viti 1990, bashkë me Shoqatën "Dom Mikel Tarabulluzi", famullia organizon manifestimin tradicional kulturor, letrar e shkencor "Takimet e Dom Mikelit". (Sarë Gjergji)

FAMULLIA E SHËN NDOUT, PRISHTINË.

Njësi e organizimit fetar për territorin e Prishtinës. Si famulli përmendet për herë të parë në vitin 1387, përkatësisht Kishat e Shën Marisë



FAMULLIA E SHËN NDOUT NË PRISHTINË

dhe të Shën Nikollës dhe disa famullitare të periudhës së shekujve XIV-XV. Gjatë sundimit osman, famullia e Prishtinës përmendet nga vizitorët apostolikë Pjetër Mazreku, Gjergj Bardhi, Fra Kurbini, Shtjefën Gaspri. Ata përmendin dy kisha: Kishën e Shën Marisë dhe Shën Prendës dhe famullitarët e Prishtinës, Ndre Bogdanin (më vonë argjipeshkëv i Ohrit), Gjon Bogdanin dhe pas tij të vëllanë, Gjergj Bogdanin, i cili na jep informata mbi xhaxhanë e tij, argjipeshkvin Pjetër Bogdanin, për vdekjen, varrosjen dhe zhvarrosjen e tij në Prishtinë. Në kuadër të famullisë së Prishtinës, gjatë periudhës osmane ishin edhe qytetet Vushtrri dhe Mitrovicë. Me vendimin e planit urbanistik të Prishtinës, pas festës së Shën Ndot më 1957, rrënohet kisha e vjetër e Shën Prendës, që ishte në qendër të qytetit (sot, shtatorja e heroit Zahir Pajaziti) dhe i jepet vendi i ri në lagjen e Ulpianës, ku është edhe

sot. Në vitin 1964 themelohet famullia e re në Prishtinë (përpara ishte filiale e Janjevës), me emrin e Shën Ndout, për nder të Shën Ndout të Padovës. Famullitari i parë ishte dom Jozhe Bakani (që shërbeu nga viti 1958-1966), më pas seleziani dom Franc Skuhalla (1966-1971), pastaj dom Zef Gashi (1971-1992), nga viti 1992 dom Nosh Gjolaj dhe më pas dom Rrok Gjonlleshaj. Në kuadër të Famullisë së “Shën Ndout” në Prishtinë janë edhe kapela e “Zojës së Papërlyer” në Fushë-Kosovë, Qendra “Don Bosko”, bashkësia e Motrave të Mëshirshme të “Shën Kryqit”, bashkësia e motrave “Bijat e Dashurisë së Krishterë” (Shën Vinkut). Së fundi në qytetin e Prishtinës gjendet edhe selia e Ipeshkvisë së Kosovës dhe Katedralja “Nënë Tereza”. (Gjon Berisha)

FAMULLIA E SHËN NIKOLLËS, VELEZHË.

U themelua në vitin 1919, me dekretin e imzot Lazër Mjedës dhe i kushtohet Shën Nikollës. Festa e famullisë është dita e Shën Nikollës më 9 maj. Famullia u pavarësua plotësisht në vitin 1923. Ajo sot përfshin vendbanimet rurale, fshatrat: Velezhë, Shpenadi, Caparc, Novakë, Smaq, Serbicë e Epërme, Serbicë e Ulët, Trepeticë, Krusha e Vogël në territorin e komunës së Prizrenit, si dhe fshatin Sallagrazhdë në komunën e Suharekës. Në famulli sot veprojnë edhe dy filiale: filiali në fshatin Sallagrazhdë, ku është ndërtuar kisha kushtuar Shën Nikollës (1973) dhe filiali në fshatin Serbicë e Ulët, ku është ndërtuar kisha kushtuar Shën Astit (1993). (Pjetër Përgjoka)

FAMULLIA E SHËN PALIT DHE E SHËN PJETRIT, GJAKOVË. Njësi e organizimit kishtar për territorin e Gjakovës. Si qendër famullitare Gjakova, me emrin famullia e Jakovës, përmendet në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës së pushtimit osman: në vitet 1625-1628 përmendet nga ipeshkvi i Lezhës dhe i Shkodrës, Benedikt Orsini, më vonë nga Gjergj Bardhi, nga dom Prend Bardhi dhe më 1671 nga Shtjefën Gaspriti etj. Nga viti 1702 Famullinë e Gjakovës e marrin në dorë françeskanët. Kuvendi Françeskan në Gjakovë u themelua në shek. XIX, përkatësisht më 1882. Në këtë kohë, pro-prefekt apostolik i misioneve françeskane për mbarë Kosovën, Maqedoninë dhe Serbinë ishte atë Emilio (Mila) nga Clesi me qendër dhe Kuvend Françeskan në Zym. Shenjtërorja e vjetër e Shën Antonit në Gjakovë

(Kisha e Patër Milës) u ndërtua me pëlqimin e argjipeshkvit të Shkupit, P. Flugencie Carev (1879-1888), ndërsa pasardhësi i tij monsinjor Andre Logoreci (1888-1892) shenjtërores së “Shën Antonit” në Gjakovë i dha çdo bekim dhe të drejtë kanonike kishtarë, që u përkasin shenjtërore të tilla. Shenjtërorja e sotme e Shën Antonit u ndërtua nga Patër Lorenc Mazreku, gjatë viteve 1930-1931. Shenjtëroren e mbajtën françeskanët deri në vdekje të Patër Lorencit (1943), ndërsa famullinë e kishin në kujdes priftërinjtë dioqezianë. Më 1958 kisha françeskane e Gjakovës në krye me dom Kruno Mikeliqin (1958-1967), prej një kishe provinciale ngritet në një kishë famullitare, e cila së bashku me Kishën e Shën Palit dhe Shën Pjetrit është ndër famullitë më të mëdha katolike në Kosovë. Aktualisht në krye të kësaj famullie është patër Ndue Kajtazi. (Gjon Berisha)

FAMULLIA E TË NGRITURIT TË SHËN MARISË VIRGJËR NË QIELL, LETNICË.

Për herë të parë përmendet si famulli në raportin e vizitorëve apostolikë T. Ragi e A.



FAMULLIA E TË NGRITURIT TË SHËN MARISË NË QIELL, NË LETNICË

Komulloviq (1584). Raportet kishtarë tregojnë se në këtë famulli u mbajtën edhe dy sinode kishtarë (1617, 1625) dhe një i tretë “në ndonjë katund të famullisë të Malit të Zi të Shkupit” (1642), që do thotë në Letnicë ose Stubëll. Burimet kishtarë po ashtu njoftojnë se famullia kishte Kishën e Shën Luigjit (1639), të Shën

Gjergjit (1641) dhe atë të Ngritjes së Zojës në Qiell (1671, ose pak më vonë). Kisha e Shën Gjergjit, sikundër edhe sot, mund të ketë qenë që atëherë në Stubëll. Kisha e tanishme e Letnicës u ndërtua në vitin 1865 mbi rrënojat e një kisha më të hershme dhe ka një arkitekturë mjaft interesante. Kisha, shenjtërore e Ipeshkvisë së Kosovës, është e një rëndësie të veçantë dhe konsiderohet mrekullibërëse, prandaj vizitohet nga komunitete të ndryshme fetare dhe nacionale nga e mbarë bota jo vetëm më 15 gusht, kur dhe është festa e famullisë, por përgjatë gjithë vitit. Në Kishën e Ngritjes së Zojës në Qiell në Letnicë, Nënë Tereza mori vendimin për misionin e saj. (Sarë Gjergji)

FAMULLIA E ZYMIT. Njihet si qendër famullitare që në shekullin XIV, me kishën që i kushtohet Të Ngriturit të Shën Mërisë në Qiell. Në famullitë e këtij rajoni, ndër priftërinjtë e hershëm ishin Ndre, Pjetër, Lukë e Gjon Bogdani, pastaj Pjetër Zogani, Mark Bardhi etj. Sot Zymi e ka kishën e “Të Ngriturit të Zojës në Qiell”, që në këto anë njihet si Zoja e Hasit (kremtohet më 15 gusht). Famullisë së Zymit i takon edhe Kisha e “Shën Prenës” në Shëngjergj. Për këtë Gjergj Bardhi në vitin 1638 raporton se kisha në Shgjeq i kushtohet “Zojës së Bekuar”, ku famullitar ishte Ndre Bogdani, kurse Gërgur Mazreku në vitin 1650 thotë se kjo kishë i kushtohet “Shën Anës”. Në lagjen Berishaj të Zymit ishte e ngritur Kisha e “Shën Gjergjit”, që tashmë i ka vetëm gërmadhat. Sipas Misionit të Zymit, me të cilin udhëhiqte dom Pal Vaccagni, misionar apostolik i kishës në vitin 1725, del se Zymit i përkisnin 17 famulli. Nga shek. XIV e deri në vitin 1688, në Zym ishte rezidenca e Prefekturës Françeskane për Dukagjin, Maqedoni e Serbi. Qendër françeskane kishte edhe gjatë periudhës 1815-1958. Në shekullin XIX rezidenca françeskane kaloi në Gjakovë. Tash në Famullinë e Zymit shërbejnë meshtarët dioçezianë. Në kushte pasigurie e në rrethana lufte, imzot Pjetër Karagiqi e strehoi Ipeshkvinë e Shkupit në Zym të Hasit. Strehimi i Ipeshkvisë së Shkupit në Zym vazhdoi për 50 vjet me radhë, me ipeshkvijtë: Pjetër Karagiqi (shërbeu në Zym gjatë viteve 1702-1727, Mihill Suma (shërbeu gjatë viteve 1727-1743) dhe Gjon Nikollë Kazazi (shërbeu gjatë viteve 1743-1752). (Frrok Kristaj)

FANAJ Shemsedin (1945-). Klarinetist. Lindi në Vërmicë të Prizrenit. Pasi kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren (1964), u regjistrua në Akademinë e Muzikës në Sarajevë, në drejtimin për vegla me frymë, klarinet (prof. A. Radan). Gjatë studimeve mori pjesë në koncerte të përbashkëta e solistike organizuar nga “Rinia muzikore”. Pas studimeve, më 1972, u punësua në Shkollën e Muzikës në Prizren. Ishte aktiv në koncerte dhe festivale në Kosovë, organizuar nga Shoqata e Artistëve Muzikorë dhe nga Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës, në “Ditët e Muzikës Kosovare” në Budva (Mali i Zi), Sarajevë (BeH), Dubrovnik (Kroaci), në Tiranë (bashkëpunime mes dy akademive muzikore, 1977). Me hapjen e degës së muzikës në kuadër të Fakultetit të Arteve (1975) ishte asistent për lëndën klarinet, më pas ligjërues dhe profesor, një kohë edhe ligjërues i lëndës muzikë kamerale (1991-1999), si dhe anëtar i Shoqatës së Artistëve Muzikorë dhe kryetar i saj. (Besa Luzha)

FANËT. Banorë të ardhur nga një rajon i gjerë i sistemit lumor të Fanit të Madh dhe të Vogël në trevën e Mirditës së Shqipërisë Veriore. Pasardhësit e fanëve në Kosovë jetojnë kryesisht në komunat e Prizrenit, të Gjakovës dhe të Pejës. Historikisht njihen si zejtarë dhe bujq. Emërtimi *Fan* (ose fand) përmendet qysh në mesjetë dhe lidhet me vendin e prejardhjes së tyre. Në kohë të hershme, bashkësia katolike ndahej në shqipfolës që jetonin në ultësira dhe në malësorë shqiptarë të ardhur. Fanët ishin zakonisht pjesëtarë fisesh. Në shekullin XIX, kur Perandoria Osmane nuk garantonte barazi juridike të nënshtetasve të saj dhe përjashtoi popullsinë e krishterë nga sistemi i krijuar nga myslimanët, malësorët shqiptarë katolikë (fanët) mund të bartnin armë, teksha shumica e të krishterëve, jo. Ata u rekrutuan nga osmanët si polici ndihmëse dhe u shërbyen besnikërisht, madje edhe kundër myslimanëve shqiptarë, që më 1878 u rebeluan kundër Sulltanit. Veshjet tradicionale të fanëve nuk ndryshojnë nga ato të Mirditës. (Ganimet Klaiqi)

FARA. (lat. *semen*) Në kuptimin gjenetik fara është organi bimëve melulesë, e cila formohet në trastë embrionale, me polenizim, me fekondim të dyfishtë, krijon embrionin, endospermën, që trashëgon dhe ruan llojin e caktuar. Në kuptimi agronomik, farë janë organet dhe pjesët e

bimëve që shërbejnë për riprodhim, kokrra, zhardhokë, qepujka, bulba, klone, sytha, rrënjë. Fermerët kosovarë prodhojnë farë nga populacionet vendore. Kjo veprimtari është ngritur në industri, sidomos për prodhimin e farës së drithërave: grurë, elb, misër, perime si dhe përpunimi i farës së jonxhës dhe i tërfilit dhe pastrim nga fara e kuskutës (*Cuscuta* sp.) me triorimi me trior magnetik. Përpunimi i farës së drithërave bëhet në Fabrikën e Farës në Klinë (1971). Varësisht nga lloji i bimëve për kultivim, përdoret fara e kultivarëve 75-80%, ndërsa e hibrideve 90-95%. Nevojat vjetore të bujqësisë kosovare për farë janë: grurë 15,000 t, elb 600 t, misër 1,700 t dhe patate 1,600 t. Me prodhim dhe përpunim të farës së grurit me kultivarë nga rajoni veprojnë dy ndërmarrjet: “Agroelita” në Klinë dhe “Semenarna Kosovë” në Lipjan (2001). Kompania “Agricokosova” në Pestovë të Vushtrrisë ka filluar me prodhim e farës së patates (2011). (Shukri Fetahu)

FARAMCISTËT PA KUFIJ (Pharmaciens Sans Frontieres). Organizatë humanitare, joqeveritare, e themeluar në vitin 1985 nga pesë farmacistë në rajonin e Clermond-Ferrandit të Francës. Ideja e themeluesve ishte që barnat e pashfrytëzuara në Francë të dërgoheshin në shtete të varfra. Në vitin 1990 në Gjenevë u krijua celula e parë e kësaj organizate dhe në vitin 1992 u krijua Komiteti Kombëtar i Farmacistëve pa Kufij në Zvicër, si rezultat i rritjes së organizatës. Parimi i punës ishte: “Shkatërro barnat e skaduar, dhuro barnat e pashfrytëzuara”. Për arsye të rritjes së nevojës për më shumë farmacistë në vendet në nevojë, në vitin 1994 u krijua Komiteti Ndërkombëtar i Farmacistëve pa Kufij. Farmacistët pa Kufij e mbështesin aktivitetin e vet në Udhëzuesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për dhurim të barnave, e cila përmban edhe Kartën e Ndhmës Humanitare. Gjatë viteve '90 dhe pesë vite pas luftës në Kosovë, Farmacistët pa Kufij kanë ofruar terapinë e plotë për trajtim të tuberkulozit. (Isme Humolli)

FARLATI Daniel (1690-1773). Teolog dhe historian kishtar. Lindi në vendin San Daniele del Friuli në krahinën e Udinës në Itali. Studimet e larta i vazhdoi në Bolonjë, Padovë dhe Romë, ku u specializua në fushat e historisë kishtarë, letërsisë dhe filologjisë klasike. Më 1722 urdhërohet të kthehet në Padovë dhe

t'i ndihmojë teologut Filip Riçeputi në përgatitjen e historisë kishtarë të quajtur “Illyricum Sacrum”, me të cilën është marrë deri në vdekje. Farlati u bë i famshëm në studimet tij, që i referohen dokumentacionit historik të Ilirikut, përkatësisht ipeshkvive të Dalmacisë dhe Arbërisë. Farlati, së bashku me F. Riceputin, përnjëzet vjet hulumtoi lëndën burimore në të gjitha arkivat e Mesdheut, për të përgatitur botimin e kësaj veprë shumëvëllimëshe. Si rezultati i kësaj pune hulumtuese pasoi grumbullimi i 300 vëllimeve (dorëshkrime) me dokumente të rëndësishme për periudhat e ndryshme historike. Pas vdekjes së bashkëpunëtorit të tij, Riceputi (1742), Farlati zgjodhi si bashkautor At J. Coletin-in dhe së bashku përgatitën për botim vëllimin I, i cili u botua në Venedik në vitin 1751. Vëllimi I trajton historinë e krishterimit për Dioqezën e Salonës (qytet i antikitetit afër Splitit të sotëm në Kroaci) deri në shek. IV. Në vitet e mëpastajme u botuan edhe vëllimet II, III, IV. Vëllimi V u botua pas vdekjes së Farlatit, në vitin 1775. J. Coleti do të vazhdojë botimin e vëllimeve VI, VII dhe VIII. Vëllimi i fundit u botua në vitin 1819. Vëllimi VII, dhe sidomos vëllimi VIII, përfshijnë lëndë të pasur, që i referohet edhe arealit të Kosovës së sotme. (Muhamet Mala)

FASLIA Sak (1885-1944). Bajraktar nga Rugova e Pejës, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Koshutan të Rugovës. U dallua që në vitin 1911 në luftën e Beranës kundër forcave malazeze, si prijës i luftëtarëve shqiptarë. Kur forcat malazeze sulmuan Rugovën në vitin 1912, ai, së bashku me bashkëluftëtarë nga rajoni i Rugovës, i thyen këto forca. S. Faslia e vazhdoi luftën kundër forcave serbo-malazeze që nga pushtimi i Kosovës në vitin 1912 e deri në Luftën e Dytë Botërore. Në korrik të vitit 1941, përfaqësuesi ushtarak i qeverisë shqiptare, major Kolë Bibë Mirakaj e emëroi S. Faslinë si udhëheqës të luftës për mbrojtjen e kufirit me Malin e Zi. S. Faslia mori udhëheqjen e Batalionit “Gramos”. Me bashkëluftëtarët e tij nga krahina e Rugovës u shqua edhe në luftë për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë dhe më pas të Pazarit të Ri. Në njërin nga këto beteja u plagos. Në prill të vitit 1944 u plagos përsëri, ndërsa pas shërimit e vazhdoi luftën, deri kur u vra në luftë kundër forcat malazeze në Majën e Smilovicës. Në qershor të vitit 2004, me rastin e 60-vjetorit të vrasjes së tij, nga presidenti i Kosovë u shpall Hero i Kosovës. (Luan Tetaj)

FAZLIA-RADISHEVA Imer (1908-1947). Udhëheqës i vullnetarëve në Luftën e Novi Pazarit dhe Kolashinit. Lindi në Radishevë të Skënderajt. Në vitin 1938 për shkak të ndjekjeve nga organet e pushtetit serb u detyrua të largohet në Shqipëri. Në vitin 1941 kthehet në Kosovë dhe inkuadrohet në administratën e shtetit shqiptar. Në vitin 1943, si komandant i vullnetarëve shqiptarë merr pjesë në luftën e Koloshinit, kundër çetave çetnike serbe, të cilat kishin bërë krime mbi popullsinë shqiptare dhe myslimane të Sanxhakut. Në janar të vitit 1945 iu bashkëngjit Brigadës së Drenicës që udhëhiqej nga Shaban Polluzha, ku u emërua komandant i batalionit II të kësaj brigade. Me bashkëluftëtarët nga Radisheva u angazhua të mbronte fshatin nga sulmet e çetnikeve dhe të partizanëve. Pas humbjes së luftës nuk pranoi t'u dorëzohej partizanëve dhe e vazhdoi qëndresën edhe në vitin 1946. Ishte pjesëmarrës në kongresin IV dhe V të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare të mbajtur më 1 maj në Kosmaq të Drenicës dhe më 15 korrik 1946 në Lipovicë. Më 11 prill 1947 vritet në pritë nga organet e OZN-ës dhe varroset fshehurazi nën kalanë e Zveçanit. (Luan Tetaj)

FAZLIJA Arsim (1984-). Aktor. Lindi në Tetovë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Tetovës (2007). Luajti në shfaqjet e realizuara në Tetarin e Tetovës: “Çmendina”, “Imprezari nga Izmiri”, “Albanikum”, “Duke pritur Godonë”, “Shtëpia në kufi”, “Syri i lig”, “Çifti i çuditshëm”, “Vdekja aksidentale e një anarkisti”, “Mundimet e kota të dashurisë”, “Art” etj. Luajti gjithashtu edhe në disa shfaqje për fëmijë, si: “Trimi dhe kuçedra”, “Maçorri me çizme” dhe “Vonesa e Babadimrit” etj. Ka fituar disa çmime në festivale të ndryshme. Është regjisor i një filmi të shkurtër, të një filmi dokumentar dhe i serialit televiziv “Dera e madhe” (2013-2014). Nga viti 2007 është anëtar i ansambllit në Teatrin e Tetovës. (Kushtrim Bekteshi)

FAZLIU Asllan (1924-1986). Politikan. Lindi në Bllacë të Suharekës. Kreu Medresenë e Madhe në Shkup, shkollën normale “Sami Frashëri” në Prishtinë dhe Shkollën e Lartë të Shkencave Politike në Beograd. Magjistroi në temën mbi autonominë e Kosovës, të cilën më vonë e botoi si libër me titull: “Autonomia e Kosovës



ASLLAN FAZLIU

dhe Metohisë në Jugosllavinë Socialiste” (1966). Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore punoi mësimdhënës në Shkollën Normale të Gjakovës (1948/49). Ishte kryeredaktor i gazetës “Rilindja” dhe më vonë edhe drejtor i kësaj ndërmarrjeje. Ushtrroi funksione të larta partiake e shtetërore në Kosovë dhe në Federatën Jugosllave: kryetar i Këshillit të Rrethit të Suharekës, kryetar i Komitetit Komunal të Lidhjes Komuniste të Prishtinës, kryetar i Dhomës Federative të Kuvendit të Jugosllavisë etj. (Blerim Reka)

FAZLIU Bahri (1971-1998). Veprimtar politik i lëvizjes çlirimtare, njëri nga themeluesit e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Llaushë të Podujevës. Ishte vëllai më i ri i Fahri Fazliut, i cili ra në një përballje me forcat policore në Lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë, bashkë me Afrim Zhitinë. Angazhimet e para politike i filloi në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Ishte themelues dhe botues i gazetës ilegale “Çlirimi”, organ i LKÇK-së. Ai udhëhoqi botimin e kësaj gazete nga shtatori i vitit 1994 deri në maj të vitit 1998. U angazhua për bashkimin e forcave politike dhe ushtarake në Kosovë. Ra në luftë me forcat ushtarake dhe policore serbe në bjeshkën e Bogiqës, në rrethin e Plavës në Malin e Zi më 7 maj 1998, në trekufirin Shqipëri, Mali i Zi dhe Kosovë. La të botuar një numër shkrimesh publicistike dhe krijime poetike. Është i dekoruar me urdhrin “Hero i Kosovës”. (Ismet Cakiqi)

FAZLIU Bejar (1968-). Instruktor i karatesë. Lindi në fshatin Raincë të komunës së Preshevës. Studioi në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe të Sportit të Universitetit të Prishtinës. Karatenë e filloi kur nisi studimet në Prishtinë në klubin “Batllava”. Pas luftës në Prishtinë themeloi Federatën e Karatesë Tradicionale të Kosovës (FKTK), e cila, që në vitin 2002, është njohur zyrtarisht nga Federata Ndërkombëtare e Karatesë Tradicionale. Në vitet në vijim, si instruktor i shkathtësive luftarake, punoi në aftësimin e pjesëtarëve të Gardës së Kosovës në TMK. Në vitin 2006 vendoset në Filadelfia të SHBA-së. Atje themeloi Qendrën e Karatesë Tradicionale, ndërsa punon edhe si instruktor

kryesor në Shkollën Koreane të Karatesë “Pro Martial Arts”. Aktualisht është ndër instruktorët më të kërkuar të arteve marciale. Është i licencuar nga Federata Ndërkombëtare e Karatesë Tradicionale në Los Anxhelos të Kalifornisë në SHBA. Ka përkthyer dhe botuar disa libra në gjuhën shqipe, si “Fjalor i karatesë”, “Doracak i karatesë tradicionale”, “Rregullat e garave të karatesë tradicionale”, “Fjalor i karatesë për shotokan” etj. Jeton dhe vepron në SHBA. (Lulzim Shala)

FAZLIU Fahri (1963-1989). Veprimtar i lëvizjes për çlirim kombëtar, Hero i Kosovës. Lindi në Llaushë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Zhvilloi aktivitet të dendur që në kohën e demonstratave gjithëpopullore në pranverën e vitit 1981: shpërndau trakte, literaturë ilegale, ndihmoi shokët ilegalë dhe familjet e të burgosurve politikë etj. Pas kthimit nga shërbimi ushtarak, filloi punën në ndërmarrjen hekurudhore “Prishtina”. Në vitin 1984, për shkak të aktivitetit politik, u arrestua dhe u dënua me katër vjet burg. Pas daljes nga burgu, përfundoi Shkollën e Lartë të Komunikacionit në Zagreb dhe ndoqi studimet në degën e ndërtimtarisë të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës. Në vllimet politike të viteve 1988-89 ishte shumë aktiv. Së bashku me Afrim Zhitinë luain rolin e qendrës koordinuese të zhvillimeve politike në Prishtinë dhe Podujevë. Kjo veprimtari e tyre vëzhgohej nga shërbimi sekret serb. Më 2 nëntor 1989, F. Fazliu së bashku me Afrimin Zhitinë u rrethua në banesën e tyre në lagjen “Kodra e Diellit” në Prishtinë. U vra nga forcat serbe, së bashku me Afrim Zhitinë, pas një rezistence të armatosur. Pas luftës u shpall Hero i Kosovës. (Haki Kasumi)

FAZLIU Hajrush (1949-). Piktur. Lindi në Karaçevë të Kamenicës. Kreu shkollën e mesme në Gjilan, degën e artit figurativ në Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) në Shkup (1972), studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1980), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare (1997). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe në dy mandate kryetar i saj. Është mësimdhënësi i lëndës së metodikës të artit figurativ dhe i pikturës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punoi edhe në SHLP në Gjilan dhe në Universitetin e Tetovës. Është i njohur



HAJRUSH FAZLIU

si krijues i figuracionit kompozicional dhe kultivon frymën lirike të realizmit të ri magjik. Hapi disa ekspozita personale, si: në Teatrin “Dodona” të Prishtinës (1997), në Galerinë e Muzeut Historik në Tiranë (2006), në Galerinë Nacionale në Shkup (2006), në Galerinë e qytetit në Gostivar (2007), në Galerinë Nacionale në Tetovë (2008), pastaj në galeritë në Shtip (2009), Strumicë (2009) etj. Mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive në Prishtinë, Shkup, Tiranë, Namyr (Belgjikë), Paris, Boholt (Gjermani), Teksas etj. Është fitues i disa çmimeve në manifestime të ndryshme. Në vitin 2000 u nderua me “Medaljen për merita” nga komandanti i trupave të NATO-s, gjenerali K. Reinhard, pastaj mori çmimin “Grand Prix” në Sallonin e Artit (2005-2008), si dhe çmime e mirënjohje të tjera në Belgjikë, Pejë, Gjilan, Prishtinë etj. (Rexhep Ferri)

FAZLIU Ismet (1962-). Piktur. Lindi në Prishtinë, ku mori shkollimin bazë dhe më pas kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1986). Hapi ekspozita personale dhe mori pjesë në ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit, të organizuara kryesisht nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës. Më 2002 ekspozoi në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, ndërsa më 2003 në Galerinë e Arteve të Kosovës. Më 1998 mori çmimin e parë në Bienalen e Vizatimit. Është krijues i portreteve dhe i peizazheve realiste. (Rexhep Ferri)

FAZLIU Shekip (1975-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkëluftëtar i Adem Jasharit. Lindi në Klinë të Ulët të Skënderajit. Më 1996 u inkuadrua në radhët e UÇK-së. Ishte ndërlidhës i komandantit Adem Jashari me Rustem Mustafa-Remin. Më 5 mars të vitit 1998 mori pjesë në Epopenë e UÇK-së në Prekaz. Ishte bashkëluftëtari i fundit i ndarë nga familja Jashari. Pasi i mbijetoi sulmit të 5 marsit të vitit 1998 mbi Jasharajt, dha një kontribut të veçantë në organizimin dhe strukturimin e formacioneve të UÇK-së në Zonën Operative të Drenicës dhe në Zonën Operative të Shalës. Në qershor të vitit 1998 formoi kompaninë e

4-të të batalionit të 3-të të Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”, ku edhe u emërua komandant. Pas përfundimit të luftës, u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, si oficer për marrëdhënie civile-ushtarake me gradën nënkolonel. Jeton në Zvicër. (Sabit Syla).

FEHIMI Nehar (1933-2010). Gazetar. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, kurse studimet për gjuhët romane i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Në gazetën “Rilindja” punoi që nga viti 1958, prej nga kaloi në Radio Prishtinë, ku raportoi dhe bëri shkrime autoriale nga fusha e artit, kulturës dhe sportit. Trajtoi edhe një sërë temash nga gjuhësia dhe kultura e gjuhës. Bëri një sërë intervistash me personalitete të shquara të kulturës dhe të jetës publike në Kosovë. Mbahen në mend raportet e tij nga solemniteti i dorëzimit të çmimit Nobel për Paqe që iu dha Nënë Terezës, si dhe intervista me laureaten shqiptare. (Nehat Islami)

FEHMIU Agon (1971-). Gazetar i sportit, basketbollist, trajner. Lindi në Prishtinë. Karrierën e basketbollistit e filloi në KB “Prishtina”, ku kaloi nëpër të gjitha kategoritë dhe grupmoshat. Ishte reprezentues i Kosovës. Luajti për KB “Prishtina”, “Slloga” (Shkup) “Pertevniyal” dhe “Yesilyurt” (Stamboll), ndërsa në vitin 1994 filloi profesionin e trajnerit/mësues me kategori të reja, duke e hapur shkollën e parë private të basketbollit në Kosovë (“A.A.F 5”). Gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll punoi si trajner dhe drejtor i klubeve për grupmosha të reja. Në vitin 1998 ishte bashkëthemelues dhe koordinator i shkollës private të basketbollit “Akademik Basketboll Okulari”. Së fundmi, ka kryer Shkollën e Trajnerëve të Basketbollit të Institutit “Euroleague” për basketboll. A. Fehmiu ka magjistruar edhe për gazetari dhe komunikim. Pas kthimit në Kosovë në vitin 2000 filloi punën e gazetarit të sportit në gazetën “Koha ditore” dhe nga viti 2001 redaktor i sportit në “Kohavision”. (Edmond Thaçi)

FEHMIU Arsim (1932-). Mësimdhënës, trajner, punëtor sportiv. Lindi në Sarajevë. Shkollën fillore e nisi në Sarajevë, e vazhdoi në Shkodër e Prizren, ku e kreu klasën e pestë. Pas shkollës fillore vazhdoi mësimet në Gjimnazin real të Prizrenit. Në vitin 1947 i kreu katër klasë gjimnazi dhe semimaturën. Shkollën normale



ARSIM FEHMIU

e kreu në Gjakovë më 1949. Pas normales, në vitin shkollor 1949/50 hospitoi shkollën e mesme të fizkulturës në Zemun. Institutin Shtetëror të Fizkulturës, DIF-in, dhe Shkollën Federative të Trajnerëve, degën e futbollit, i kreu në Beograd, ku e dorëzoi edhe disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Beogradit, pasi më parë kreu studimet pasuniversitare dhe u magjistrua në Shkup. Pos punës si mësues, arsimtar dhe profesor i kulturës fizike dhe trajner i futbollit, në procesin mësimor e pedagogjik, është marrë edhe me hartimin e planprogrameve të trajnimeve sportive. Është hartues i projektit për botimin e teksteve mësimore nga lëmi i kulturës fizike për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës. Ka qenë dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës. Si bashkëpunëtor i Entit për Kërkime Ekonomike ishte udhëheqës i projektit për zhvillimin e veprimtarive shoqërore të Kosovës për lëmin e kulturës fizike. Pas pensionimit (1991) u riaktivizua si komisar i Federatës së Futbollit të Kosovës. Nga viti 2006 emërohet kryetar i Komisionit “Akademia Olimpikë e Kosovës” në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës. Si pedagog dhe punëtor sportiv u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Leutrim Mustafa)

FEHMIU Bashkim (1930-2008). Inxhinier i arkitekturës, profesor universitar. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prizren dhe Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Beogradit (1958). Ishte arkitekti i parë shqiptarë në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. Pas diplomimit punoi në ndërmarrjen ndërtimore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë. Themeloi dhe udhëhoqi Entin Urbanistik Komunal të Prishtinës (1960). Në vitin 1970 u zgjodh docent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Është autor i disa studimeve për planin e përgjithshëm



BASHKIM FEHMIU

urbanistik të Prishtinës (1953), për planin hapësinor të Prishtinës deri në vitin 2000, për Gërminë si hapësirë e veçantë natyrore dhe funksionale në territorin e Prishtinës, pastaj i analizës së lokacionit të termocentraleve në Obiliq nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit etj. Hartoi projektet ideore për stadiumin e Prishtinës (1962), për “Grand Hotel Prishtina” (1973), projektin e kampusit të UP-së (1971), bëri analizën dhe vlerësimin e planit hapësinor të Kosovës (1972) etj. Udhëhoqi dhe hartoi programin dhe planin urbanistik të Kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz (2001). Është ndër themeluesit e studimeve të arkitekturës në UP. Mori pjesë në shumë simpoziume, kongrese dhe juri profesionale në të gjitha kryeqytetet e ish-Jugosllavisë, por edhe në Sofje, Romë, Madrid, Paris, Tiranë, Meksiko etj. Ishte laureat i shumë çmimeve profesionale, mirënjohjeve dhe dekoratave. (Dervish Qerreti).

FEHMIU Bekim (1936-2010). Aktor. Lindi në Sarajevë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren. Më 1955 u pranua si aktor në Teatrin Popullor Krahinor në Prishtinë. Aty fillimisht luajti në shfaqjen “Halit Gashi” dhe më pas në shfaqjet “Koshtana”, “Kryet e hudurës” dhe “Parajsa e humbur”. Kreu studimet për aktrim në Akademinë për Teatër dhe Film në Beograd (1960). Prej vitit 1958 e deri më 1967 luajti në



BEKIM FEHMIU

Teatrin Jugosllav të Dramës, në ansamblin e të cilit u pranua si aktor më 1960. Më tutje, deri më 1987, punoi si aktor i lirë në Teatrin Popullor të Beogradit dhe në Teatrin “Atelje 212”. Në shfaqje të ndryshme luajti mbi 40 role. Në fillim të viteve '70, për një kohë të shkurtë, ishte një nga profesorët e aktrimit në degën e dramës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më 1987, për shkak të propagandës antishqiptare në Serbi, në shenjë proteste e braktisi teatrin. Më shumë se me teatrin, identifikohet me filmin. Ka luajtur kryesisht në role kryesore në mbi 50 filma të kinematografisë jugosllave dhe botërore. Shkëlqimi i tij si aktor zë fill me filmin “Mbledhësit e puplave” (1967), me regji të Aleksandar Petroviqit. Suksesi me këtë film (i nominuar për dy çmime në Festivalin e Kanës dhe për Çmimin Oscar), ia hapi portat e

kinematografisë botërore. Në këtë kohë nënshkruan një kontratë disavjeçare me producentin italian Dino de Laurentis. Që atëherë luajti përkrah yjeve të kinematografisë botërore (Irena Papas, Claudia Cardinale, Ava Gardner, Richard Crenna, John Huston, Charlton Heston etj.) në filmat e produksioneve të mëdha ndërkombëtare. Një nga kryeroret e tij është ai i Uliksit në serialin televiziv “Odiseu” (1968) me regji të Franco Rossi-t. Ndërkaq më pas luajti në filmat: “Aventurierët” (1970), “Dezertori” (1971), “Dëbora e fundit e pranverës” (1973), “Heshtja e dëshmitarit” (1974), “Loja e së vërtetës” (1974), “Cagliostro” (1975), “Libera, dashuria ime” (1975), “Salloni Kiti” (1976), “E diela e zezë” (1977), “Fëmija me emrin Jezus” (1987), “Xhulia e dëshpëruar” (1989), “Xhingis Khan” (1992), “Zemra dhe shpata” (1998) etj. Njihej si një nga aktorët e parë të përmasave botërore nga ish-Jugosllavia dhe përgjithësisht nga vendet lindore të bllokut komunist. U nderua me çmime, në ish-Jugosllavi (“Arena e argjendtë”, “Perandori Konstantin”, Grand Prix “Qele Kulla” etj.) dhe në Itali (“Grand Prix”, Monedha e Artë e Bergamo-s, Grand Prix “Laceno D'oro XV Rassegna del Cinema Neorealista D'Avanguardia” dhe “Maschera d'argento”). Është autor i librit autobiografik “Shkëlqim dhe tmerr”. (Bekim Lumi)

FEHMIU Ibrahim (1892-1951). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, ku kreu edhe shkollën fillore. Kreu edhe idadijen e Shkupit, si dhe kursin pedagogjik në Pejë (1915). Punës



IBRAHIM FEHMIU

arsimore ia filloi në vitet 1912-15, kur në shtëpinë e tij dhe në xhaminë e Gërçarëve u mësonte ilegalisht të rinjve të lexonin dhe të shkruanin shqip. Punoi si mësues në Gjakovë dhe kontribuoi për hapjen e shkollave shqipe në Junik, në Voksh dhe në Irzniq. Pas Luftës së Parë Botërore, pas ripushtimit të Kosovës nga forcat serbo-malazeze, u vendos në Malësinë e Gjakovës. Ishte mësues në Kavajë, në Krujë dhe drejtor i konviktit “Kosova” në Krumë. Në vitin 1926 kthehet në Gjakovë, ku vazhdoi ilegalisht veprimtarinë patriotike, për çka autoritetet jugosllave e internojnë. Sërish kthehet në Shqipëri, punon si mësues

në Burrel dhe në Shkodër. Në prill të vitit 1941 kthehet në Kosovë për mëkëmbjen e arsimit dhe të shkollave shqipe. Ishte drejtor didaktik i shkollave fillore shqipe, këshilltar dhe inspektor arsimit në Prizren, mësues i gjuhës shqipe dhe i historisë në gjimnazin e këtij qyteti. Pas Luftës së Dytë Botërore e emëruan zëvendës drejtor të gjimnazit të Prizrenit, por me kërkesën e tij punoi si mësues. Në vitin 1948, për shkaqe politike, autoritetet jugosllave e burgosin dhe e internojnë në Beograd. Në fund ishte mësues në shkollën fillore “Bajram Curri” në Prizren, ku edhe vdiq. U varros si atdhetar i shquar, me nderime të mëdha. (Linda Salihu)

FEJESA. Fejesa është akt ceremonial që i paraprin martesës. Me fejesë zë fill zyrtarizimi i lidhjes midis dy të rinjve dhe i miqësisë ndërmjet dy familjeve. Si akt ceremonial, fejesa e tejkalon një lidhje ndërmjet personave që martohen, ka një trajtim të veçantë në traditën popullore shqiptare. Edhe në Kosovë deri vonë janë ruajtur disa norma kanunore, që sugjerojnë miqësi të qëndrueshme: që vajza të mos jetë gjak e gjini, të mos jetë e të njëjtit fis, të mos jetë mbesë e fisit të djalit, të mos jetë grua e lëshuar, të mos ketë kumbari. Shkuesi apo mësiti si institucion tradicional, zë një vend të rëndësishëm në lidhjen e miqësisë dhe në ceremoninë e fejesës. Sipas Kanunit, në fejesë “është kanu” që të shkojë shkues i ati a vëllai i djalit te prindërit e vajzës, për të dërguar “shejin”, i cili përbëhet prej një unaze, që as ndërrohet, as kthehet për të gjallët e atij që zë nuse. Shkuesi, pa e zgjatur, sa të pijë kafën, ia zë në gojë shtëpiakut qëllimin e vizitës. Anëtarët e familjes, nëse kanë pleqëruar gjatë natës për këtë çështje, fjalën e kanë dhënë të nesërmen ose një ditë më vonë, por me “ditë parë”, domethënë para dreke. Pastaj shkuesi e përcjell lajmin te familja që e ka lypur vajzën. Për këtë rast, si familja e vajzës, ashtu edhe ajo e djalit qesin kafë e diku-diku edhe raki, si shenjë gëzimi. Përgëzime marrin edhe nga i tërë komuniteti. Pas fejesës, varësisht se në cilën moshë janë të fejuarit, fillojnë planet për martesë dhe dasmë. (Zanita Halimi)

FEJZA Belgjyzare (1927-2006). Aktore. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Në vitin 1952 u angazhua në Teatrin Popullor Krahinor (TPK), ku interpretoi dhjetëra role, kryesisht dytësore dhe episodike.

Ishte njëra nga doajenet e teatrit në Kosovë. Ndër rolet e saj më të rëndësishme në skenën e TPK-së janë: Jevgia e vejë në shfaqjen “Zona e Zamfirrit” (1952), Zylkia në “Halit Gashi” (1955), Zonja Pernelë në “Tartufi” (1965), Zonja Filimon në shfaqjen “Njeriu që pa vdekjen me sy” (1974) etj. Luajti edhe në filma artistikë dhe drama televizive. (Arian Krasniqi)

FEJZA Islam (1961-). Inxhinier i gjeologjisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Zhabar të Mitrovicës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Mitrovicë, studimet për gjeologji i kreu në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1987). Në vitin 1987 u zgjodh asistent në këtë fakultet, ku në vitin 2013 merr titullin universitar profesor i rregullt. Një kohë punoi në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, në departamentin e ujërave, ndërsa më pas ishte anëtar i bordit këshillëdhënës për mbrojtjen e mjedisit (2010). Është autor i tekstit mësimor universitar “Mikrofiziografia e mineraleve petrogjene”, autor dhe bashkautor i një sërë punimesh profesionale dhe shkencore të publikuara në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrës në simpoziume dhe konferenca shkencore i përfshirë në një numër projektesh nga fusha e gjeologjisë, e minierave dhe e mjedisit. (Izet Zeqiri)

FEJZA Shkurte (1961-). Këngëtare. Lindi në Mushtisht të Suharekës, ku kreu shkollimin fillor. Kreu shkollën e mesme në Suharekë, ndërsa shkollimin e lartë në Prizren dhe në Prishtinë. Që në paraqitjet e para u vërejt talenti për këndim. Më 1975, kur u themelua Shoqëria kulturore-artistike “Afërdita” në Mushtisht, u bë anëtare dhe me kalimin e kohës ishte vembleme e saj. Si këngëtare e muzikës popullore u prezantua në treva shqiptare e më gjerë, duke u shpërblyer me çmime të ndryshme. Veçojmë prezantimet në Festivalin e Gjirokastrës (1978), në Festivalin Botëror të Folklorit në SHBA (1994), pjesëmarrja në koncerte etj. Për shkaqe politike, më 1988 u largua nga procesi edukativ-arsimor në Mushtisht dhe vite me radhë kënga e saj u ndalua në programet e Radiotelevizionit të Prishtinës. Këngët dhe interpretimet e saj më të njohura janë: “Moj syzeza”, “Erdha nga qyteti”, “O ky vend i bukur”, “Oj Kosovë, nëna ime” (1990), “Mbahu nëno mos ke frikë”, “Kam një lot mpikton si ar”, “E

kam emrin kosovar” (1997), “Nuk ndahet Mitrovica” (2001) etj. Ka bashkëpunuar me kompozitorët P. Gaci, Z. Çoba, E. Zhulali, N. Gjoshi, A. Peçi, N. Krasniqi, V. Beqiri, Y. Asllani. (Kristina Palokaj-Perkola)

FEJZULLAHU Halil (1922-2007). Lindi në Tugjec të Kamenicës. Më 1930 bashkë me familje shpërngulet për në Turqi dhe më pastaj në Shqipëri (Fier). Në vitin 1941 kthehet në Kosovë dhe i bashkëngjitet Luftës Antifashiste Çlirimtare. Pas mbarimit të luftës, kreu detyra të rëndësishme në Drenicë, Anamoravë, Beograd dhe Prishtinë. Si amator u mor edhe me hulumtime gjeologjike në zonat e Anamoravës. Në fillim të viteve '70 braktis pozitën e lartë në Kuvendin e Serbisë dhe kthehet në Kamenicë. Me angazhimin e tij u ndërtua objekti i parë industrial, fabrika e pllakave të qeramikës “Karaçeva” në Kamenicë, e cila u bë bartëse e zhvillimit ekonomik dhe social të komunës. Në vitin 1970 u zgjodh anëtar i Kryesisë së Kosovës dhe pas mbarimit të mandatit u kthye në Gjilan dhe themeloi ndërmarrjen për prodhimin e konstruksioneve metalike “Gosha”. Për shkak të qëndrimeve politike u përjashtua nga të gjitha postet dhe funksionet. Nga viti 1994 jetoi në Shqipëri (Fier). (Daut Bislimi)

FEJZULLAHU Ibrahim (1967-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Gosponicë të komunës së Preshevës. Gjatë viteve 1993-1998 mori pjesë në aktivitetet e degës së Preshevës të Shoqatës humanitare “Nënë Tereza”. Në vitin 1998 u përfshi në radhët e UÇK-së, në Zonën e Tretë Operative, më vonë Batalioni Mbështetës i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Preshevë. I ngarkuar me detyrë për të siguruar lëvizjen e sigurt për anëtarët e Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të plagosur të UÇK-së, ra dëshmor më 29 maj 1999 në fshatin Gosponicë. (Fehari Ramadani)

FEJZULLAHU Petrit (1949-). Hendbollist. Lindi në Prishtinë. Karrierën sportive e nisi në skijim dhe në pingpong, por më vonë u shqua në hendboll. Nisi të merret me hendboll në moshën 12-vjeçare në shkollën fillore “Meto Bajraktari” në Prishtinë. Më pas, së bashku me familjen shkoi për të jetuar në Beograd, ku iu bashkua klubit të njohur “Cërvena Zvezda”. Në këtë klub ka qëndruar një kohë të gjatë, më pas

iu bashkua njërit prej klubeve më të mëdha të kohës, “Barcelonës”. Atje ai luajti nga viti 1982 e deri më 1985, duke fituar 5 trofe, tri kupa të Spanjës dhe dy kupa të Europës. Nga viti 1973 deri në vitin 1982 ka luajtur rregullisht për përfaqësuesen e Jugosllavisë. Me Jugosllavinë në vitin 1975 në Suedi fitoi Kupën e Botës, ndërsa në vitin 1982 nënkampion i Kampionatit Botëror të zhvilluar në Gjermani. Karrierën e mbylli sërish në klubin e hendbollit “Cërvena Zvezda” në moshën 36 vjeçare. Një kohë ishte trajner i hendbollit, por edhe trajner kondicional i tenistëve të njohur spanjollë. Jeton dhe punon në Barcelonë. (Albatrit Matoshi)

FEJZULLAHU Sabri (1944-). Këngëtar dhe aktor. Lindi në Podujevë. Pas shkollimit fillor dhe të mesëm u diplomua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, dega gjuhë e letërsi shqipe dhe në degën e aktrimit në Fakultetin e Arteve. Mori pjesë në një mori koncertesh dhe festivalesh. Në “Akordet e Kosovës” fitoi 18 “Okarina të arta”. Publikoi shumë albume këngësh: “Mëmëdheu”, “Ma ke prishë gjumin e natës”, “Merrma shiun e Prishtinës”, “Çika e Ulpianës” etj. Ka incizuar mbi 800 këngë, shumë prej tyre i kanë mbijetuar kohës dhe janë bërë të paharruara. Ndër këngë të njohura janë: “Merrma shiun e Prishtinës”, “Hej ai det i syrit tënd”, “Moj e mira e Besianës”, “Sytë qiellor”, “Çika e Ulpianës”, “Po të pres qe njëmijë vjet”, “Ku je Kosovë”, “Shpirt magjie”, “Takimi”, “Romantika” etj. Këndoi këngë të kompozitorëve të mirënjohur të Kosovës. Si aktor realizoi role në komedi, në drama televizive, në film dhe videoxhirime: “Një buqetë buzëqeshjesh”, “Migjeni”, “Autobusi”, “Kur pranvera vonohet”, “Në orët e vona” etj. Partnerët e tij në aktrim shpesh ishin: I. Krajkova, R. Thaçi, Xh. Qena, L. Qena, A. Ahmeti, A. Mikullovcit etj. Merr pjesë në koncerte në Kosovë, Shqipëri, Gjermani, Zvicër e shtete të tjera të Europës. (Indira Çipa)

FEJZULLAHU Xhemajl (1950-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Vojnoc të Shtimes. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Ferizaj, ndërsa atë universitar në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa tezën e doktoraturës e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP) (1999). Nga viti 1977 punoi si



XHEMAJL
FEJZULLAHU

mësimdhënës në Shkollën e Lartë Teknike në Ferizaj dhe më pas në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, ku më 2010 mori titullin profesor i rregullt. Është autor dhe bashkautor i teksteve universitare (“Hidraulika dhe

termodinamika”, “Teknikat e matjeve në energjetikë” etj.), i disa dispensave dhe i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale të publikuara brenda dhe jashtë vendit. Me qëllim të ngritjes profesionale realizoi disa qëndrime hulumtuese dhe studimore jashtë vendit, si në St. Petersburg (ish-BRSS), Cyrih (Zvicër) dhe Nyrenberg (Gjermani). Ishte pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore dhe profesionale. (Fejzullah Krasniqi)

FERAI A. Refet (1931-1981). Mjek, kirurg i përgjithshëm, primarius. Lindi në Tetovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Tetovë, u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Shkupit (1957). Specializoi për kirurgji të përgjithshme dhe ishte një ndër kirurgët e parë shqiptarë në Maqedoni. Në vitin 1976 fitoi titullin primarius, shqiptari i parë me këtë titull në Maqedoni. Ishte themelues i repartit të kirurgjisë në Spitalin e Tetovës. Gjatë 15 viteve të punës së frytshme bëri mbi 10,000 operacione kirurgjikale. (Avdyl Krasniqi)

FERATI Haxhi (1949-). Studiues i fushës politike-ushtarake, mësimdhënës universiteti. Lindi në Randobravë të Prizrenit, ku mbaroi shkollën fillore. Shkollimin e mesëm dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) për fizikë dhe kimi i kreu në Prizren, ndërsa studimet nga fusha e mbrojtjes dhe e sigurisë i mbaroi në Beograd, në Fakultetin e Mbrojtjes Popullore (1978). Studimet pasuniversitare për mbrojtje e siguri i përfundoi më 1984 në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Zagrebit, ndërsa studimet e doktoratës në fushën politiko-historike i përfundoi më 2003 në Universitetin e Prishtinës, në departamentin e historisë të Fakultetit Filozofik. Një kohë punoi mësimdhënës i mbrojtjes në gjimnazin e Prizrenit, më pastaj në SHLP të këtij qyteti. Në vitin 1986 kalon me punë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku kryen

punën e mësimdhënësit. Në vitet 1987-1989 ishte nënsekretar në Sekretariatën Krahinor të Mbrojtjes Popullore të KSA të Kosovës, ndërsa më vonë (1990-1993) ishte zëvendësministër i Mbrojtjes i Qeverisë së Kosovës në emigrim. Në vitin 1993 u arrestua dhe u dënua me 6 vjet e gjysmë burg. Gjatë viteve në vijim kreu detyra të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë. (Agim Zogaj)

FERATI Ibrahim (1959-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Bare të komunës së Mitrovicës. Kreu Shkollën e Lartë Teknike dhe Fakultetin e Makinerisë në Mitrovicë. Punoi në drejtorinë e policisë së trafikut të Kosovës deri në vitin 1990. Nga ajo periudhë ishte i angazhuar në sindikatën policore deri më 1998. Mori pjesë në të gjitha organizimet sindikale dhe të rezistencës. Me shfaqjen e UÇK-së në Shalë të Bajgorës u përfshi në organizimet e saj. Ishte njëri ndër themeluesit e Brigadës 141 “Mehë Uka” të Zonës Operative të Shalës dhe u emërua komandant i policisë ushtarake të asaj brigade. Pas luftës punoi si instruktor në Shkollën e Policisë në Vushtrri. (Emin Musa)

FERATI Igballe (1930-). Lindi në Dibër, Maqedoni. Shkollën fillore e kreu në Tiranë, ndërsa të mesmen në Tetovë. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Shkupit më 1958. Specializoi në lëmin gjinekologji me obstetrikë më 1966 në Shkup dhe është gjinekologjia e parë shqiptare në Maqedoni. Ishte themeluese e repartit të gjinekologjisë me obstetrikë në Spitalin e Tetovës. Punoi si udhëheqëse e shërbimit për mbrojtjen shëndetësore të gruas në Qendrën Mjekësore në Tetovë. Dha shembull për emancipimin e gruas në vitet shqiptare të Maqedonisë. (Binak Kastrati)

FERIZAJ. Qytet dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Kosovës, me lartësi mbidetare 580 m. Ndodhet rreth 36 km në jug të Prishtinës dhe 50 km në veriperëndim të Shkupit. Vendbanimi është formuar dhe zhvilluar në rrugën e vjetër që lidhte Bosnjën me Maqedoninë përmes komunikacionit rrugor dhe atij hekurudhor. Në aspektin komunikues paraqet një të rëndësishme, përmes së cilës lidhen shumë qendra urbane dhe disa rajone gjeografike. Vlerat e pozitës gjeokomunikative iu shtuan sidomos



FERIZAJ

pas ndërtimit të hekurudhës Mitrovicë-Ferizaj-Shkup-Selanik në vitin 1874. Nëpër këtë qytet kalon rruga magjistrale Prishtinë-Shkup në drejtimin meridional veri-jug, e cila prehet me transversalen Prizren-Gjilan-Bujanoc në drejtim lindje-perëndim.

Në burimet arkivore dhe në literaturë e hasim me emra të ndryshëm. Në gjysmën e parë të shekullit XIX, në lokalitetin Ferizaj ka ekzistuar një han për udhëtarë, të cilin e kishte vizituar edhe udhëpërshkruesi dhe gjeologu francez Ami Bue. Ky vendbanim mori emrin sipas pronarit të këtij hani, Feriz Shasivarit. Banorët e fshatrave përreth e quanin Tasjan, sipas shqiptimit turk të fjalës frënge stacion, ndërsa pushteti serb pas luftërave ballkanike e shpall qytet dhe ia ndërroi emrin në Uroshevac. Popullimi më intensiv i Ferizajt filloi sidomos pas ndërtimit të hekurudhës (1874), duke u shndërruar dalëngadalë në një qendër tregtare për popullsinë e viseve të ndryshme të Kosovës dhe më gjerë. Së pari u vendosën aty familjet e tregtarëve prizrenas, shqiptarë dhe serbë, pastaj me dëbimin e shqiptarëve nga treva e Jabllanicës dhe Toplicës, shumë familje vendosen në Ferizaj, duke shtuar dukshëm popullsinë e zonës. Në Ferizaj u vendos edhe popullsia rome nga fshatrat e Prizrenit dhe fshatrat e tjera të Kosovës. Në vitin 1913 qyteti i Ferizajt kishte 3,405 banorë, ndërsa në vitin 1923 numëronte 3,286 banorë. Ky regres demografik erdh si rezultat i shpërnguljeve të dhunshme të popullsisë shqiptare për në Turqi. Në mes të dy luftërave botërore, në Ferizaj fillon ardhja dhe vendosja e kolonëve serbë. Derisa në vitin 1948 Ferizaj kishte 6,685 banorë, në vitin 1981 qyteti kishte 37,659 banorë, kurse në regjistrimin e fundit (2011) ai ka 42,628 banorë.

Ndërtimi i hekurudhës ndikoi shumë në zhvillimin urban dhe ekonomik të Ferizajt. Në këtë periudhë fillon të marrë pamjen qendra e qytetit dhe disa lagje përreth. Tregtarët dhe zejtarët filluan të ndërtojnë shtëpi dhe dyqane, ndërsa nga objektet publike dallohet administrata komunale e kohës turke. Ndërmjet dy luftërave botërore, përmes planit rregullues, qyteti zhvillohet përgjatë rrugës për Prizren. Në këtë periudhë ndërtohet shtëpia e kulturës, gjimnazi i vjetër dhe konvikti, shkolla fillore "Tefik Çanga" etj. Ngrihen gjithashtu kisha katolike dhe ajo ortodokse. Pas Luftës së Dytë Botërore zhvillimi i industrisë e bëri Ferizajn shumë atraktiv për popullsinë e fshatrave përreth dhe të viseve të tjera të Kosovës. Filloi urbanizimi i qytetit, u ndërtuan shumë objekte banesore, sheshi, përmirësohet infrastruktura etj. Para Luftës së Dytë Botërore kishte ekzistuar vetëm një fabrikë për prodhimin e tullave dhe tjegullave, ndërsa më vonë ndërtohet fabrika e vajit, kombinati i drurit, fabrika e tubave etj. Pas luftës së vitit 1999, Ferizaj bëhet një ndër qendrat tregtare ndër më të zhvilluara në Kosovë, ndërsa fabrikat dhe ndërmarrjet që më parë ishin shtyllë e zhvillimit ekonomik, përmes privatizimit e kanë ndryshuar destinimin primar, ose i kanë zvogëluar maksimalisht kapacitetet prodhuese. Ferizaj është qendër rajonale për komunat Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit dhe Shtime. (Ramiz Cërvadiku)

FERIZAJ (komuna). Shtrihet në jug të Rrafshit të Kosovës, ndërmjet Malit Sharr në jugperëndim dhe malit Zhegoc në lindje. Në pjesën perëndimore shtrihen malet Jezerc dhe Nerodime, ndërsa në skajin lindor mali Zhegoc. Lartësia mesatare mbidetare është 700 m. Komuna e Ferizajt kufizohet në veri me Lipjanin, në verilindje me Gjilanin, në lindje me Vitinë, në jug me Kaçanikun, në jugperëndim me Shtërpçën, në perëndim me Suharekën dhe në veriperëndim me Shtimen. Ka sipërfaqe prej 345 km² dhe përfshin 3.16% të territorit të Kosovës. Territori i komunës dallohet për pozitë të rëndësishme gjeografike, sepse paraqet hapësirë kaluese nëpër të cilën përshkohen rrugë të rëndësishme automobilistike dhe hekurudhore në drejtimin veri-jug dhe lindje-perëndim. Pozita e volitshme fillon të valorizohet sidomos pas ndërtimit të hekurudhës Mitrovicë-Shkup-Selanik (1874) dhe pas ndërtimit të rrugëve

moderne automobilistike kah fundi i viteve '60 të shekullit XX, të cilat lidhin këtë komunë me Prishtinën dhe qendrat e tjera të Kosovës dhe të rajonit. Klima është kontinentale, sasia e reshjeve rreth 600 mm. Rrjetin hidrografik e përbën lumi Nerodime, i njohur për bifurkacionin dhe lumi Sitnica, i cili buron në territorin e kësaj komune. Komuna përbëhet prej 45 vendbanimeve, të cilat janë të organizuara në 11 bashkësi lokale. Qendër urbane dhe administrative e komunës është Ferizaj, i themeluar pas ndërtimit të hekurudhës (1874). Në ndarjen administrative të periudhës osmane, treva e Ferizajt ishte pjesë e nahisë së Moravës, që i takonte vilajetit Vëllk. Gjatë Luftës së Parë Botërore territori i kësaj komune ishte nën pushtimin bullgar dhe austro-hungarez. Pas Luftës së Parë Botërore, me ndarjen administrative në qarqe dhe rrethe, territori i Ferizajt i takon rrethit të Nerodimes në qarkun e Kosovës, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, Ferizaj bëhet nënprefekturë dhe përfshihet në prefekturën e Prishtinës. Deri në vitin 1988 pjesë administrative të komunës së Ferizajt ishin komuna e Shtimes dhe Shtërpçës dhe me këtë përbërje kishte një territor prej 694 km². Në regjistrimin e popullsisë në vitin 1948, në 45 vendbanimet e komunës kanë jetuar 30,596 banorë, ndërsa në regjistrimin e fundit (2011), komuna e Ferizajt kishte 108,610 banorë.

Deri pas Luftës së Dytë Botërore komuna ishte tipike agrare. Me rreth 90% të popullsisë së inkuadruar në bujqësi dhe me 70% në realizimin e të ardhurave, bujqësia ishte veprimtaria kryesore ekonomike. Më vonë, përveç sektorit privat, bujqësia ishte e organizuar edhe në sektorin shoqëror. Nga kulturat bujqësore janë kultivuar drithërat dhe bimët industriale, si luledielli, duhani, plantacionet e pemëve etj. Deri pas Luftës së Dytë Botërore këtu ka punuar vetëm një fabrikë për prodhimin e tullave dhe tjegullave, ndërsa më vonë u zhvillua industria metalike, e përpunimit të drurit, ushqimore, elektroindustria etj. Ekonomia e Ferizajt sot karakterizohet nga zhvillimi i hovshëm i sektorit privat. Përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, disa reparte industriale kanë vazhduar aktivitetin e njëjtë, disa të tjera e kanë ndryshuar destinimin dhe disa janë mbyllur. Sot në territorin e komunës së Ferizajt ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 4,000 biznese. Komuna e Ferizajt është qendër e rëndësishme arsimore, ka gjithsej 37 shkolla fillore, 7 shkolla të mesme

dhe Universitetin e Shkencave të Aplikuara. (Ramiz Cërvadiku)

FERIZI Avni (1936-1999). Projektant i tekstilit. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa Shkollën Normale e mbaroi në Prishtinë (1956). Kreu Akademinë e Arteve Aplikative (seksion i tekstilit) në Beograd (1964). Pas diplomimit punoi si disejnator në kombinatin e tekstilit "Emin Duraku" në Gjakovë. Gjatë kësaj kohe jepte mësim në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Më 1968 u zgjodh drejtor i Shkollës së Mesme të Tekstilit në Gjakovë. Nga viti 1971 punoi kreator mode në fabrikën e konfeksionit "Jatex" në Gjakovë. Në Televizionin e Prishtinës punoi dy vjet kostumograf, ku realizoi kostume për shumë drama, seriale televizive, emisione argëtuese dhe programe të tjera. Ishte kostumograf i filmit artistik "Era dhe Lisi" (1978). Fitoi disa mirënjohje dhe çmime profesionale. Tri herë mori çmimin e parë "Zlatna Koshuta" në Panairin Ndërkombëtar të Beogradit. U ekzekutua në shtëpinë e tij më 25 mars 1999 nga forcat paramilitare serbe. (Blerim Luzha)

FERIZI Jusuf (1836-2003). Gazetar. Lindi në fshatin Kodrali të Deçanit. U diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Si student filloi punën në Radio-Prishtinë, prej nga kaloi në gazetën "Rilindja". Në vitin 1974, pas themelimit të Televizionit të Prishtinës, vazhdoi punën në këtë institucion, si gazetar-reporter dhe moderator emisionesh. Në vitet 1980-1984 ishte korrespondent i Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP) për Lindje të Mesme, me seli në Aman të Jordanisë. Pas kthimit në Prishtinë vazhdoi punën e gazetarit dhe redaktorit deri në mbylljen e RTP-së (1990). (Nehat Islami)

FERIZI Mustafa (1941-2011). Piktur, kritik arti. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit i kreu në Pejë, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Punoi në Bashkësinë e Kulturës të Kosovës (BVI) deri në mbylljen e saj. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), një kohë dhe kryetar i saj, si dhe anëtar i Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës. Hapi disa ekspozita personale, si në foajeun e Teatrit Popullor të Prishtinës më 1974, në Universitetin e Punëtorëve "Gjuro Sallaj" në Beograd, në



MUSTAFA FERIZI

galerinë e arteve të kolonisë së Grozhnjani (1977), në galerinë e qytetit në Mostar (1978), në Galerinë e Arteve të Kosovës (1986), pastaj në Dy-seldorf, Strugë etj. Mori pjesë në ekspozitat e organizuara nga SHAFK-u dhe në manifestimet e tjera të përbashkëta në vend dhe jashtë. Krahas krijimtarisë figurative, u mor dhe me kritikë arti dhe eseistike. Vështrimet kritike dhe recensionet kryesisht i botoi në gazetën “Rilindja”, më vonë “Bujku”, pastaj në “Fjala”, “Zëri”, “Koha ditore”, si dhe ishte autor i emisioneve për artin në radio e TV. Në vitin 1984 botoi librin “Refleksione vizuele”, me shkrime për krijues kosovarë. (Hivzi Muharremi)

FERIZI Niman (1892-1937). Mësues i Popullit, atdhetar. Lindi në Gjakovë, kreu idadien e Shkupit dhe punoi si mësues në Vlorë, Berat, Has e Gjakovë, si dhe në normalen turke të Shkupit. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë (1912). Luftoi shumë për shkollën shqipe në Kosovë. Në vitin 1916 hapi shkollën shqipe “Skënderbeg” në Gjakovë, ku punoi si mësues. Punoi dhe hapi shkolla në Krumë të Kukësit, Golaj, Shtiqen, Bicaj, Kalis, Bujan etj. Ishte drejtori i parë i konviktit “Kosova” në Krumë, më pas prefekt dhe sekretar i Bajram Currit, deputet i Tropojës, veprimtar i shquar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, dega në Gjakovë, ku u angazhua edhe për sjelljen e librave shqipe nga Shqipëria. N. Ferizi ishte edhe autor artikujsh në gazeta të kohës, si dhe i monografisë “Familja Curri” (1935). (Valentina Nimonaj-Hoti)

FERIZI-BUZA Bardha (1964-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Shkollimin e kreu në Prishtinë, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1990). Ndër ekspozitat vetjake veçohen ato në Galerinë “Vizioni 2000 +” në Gjakovë në vitet 2001-2003, pastaj në Prishtinë, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, si dhe në Galerinë “Kult” dhe “Hamam” në Gostivar (Maqedoni) më 2003. Mori pjesë në ekspozitat: Salloni Pranveror, Salloni i Nëntorit i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, pastaj në ekspozitën “Arti pamor i Gjakovës” (2008), në ekspozitën për çmimin “Muslim Mulliqi”,

në ekspozitën në Prishtinë dhe në Zvicër me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeu, në ekspozitën “Expo Diaspora fine art” në Kunsthaus Bocholt, Gjermani (2014), si dhe në ekspozitën ndërkombëtare “Ndal dhunën ndaj grave” në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Itali, Spanjë dhe Argjentinë. Është mësime dhënë e Artit figurativ me metodologji në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, në Prizren dhe Gjakovë. (Tahir Emra)

FERMA. Formë bazë e organizimit të prodhimit dhe produkteve agrourbane në një sipërfaqe të caktuar bujqësore. Bartës i organizimit të prodhimit është fermeri, i cili njëkohësisht është kultivues dhe menaxher i drejtimit të fermës. Fermerët në kuadër të menaxhimit të biznesit tradicionalisht përqendrohen në përcaktimin e alternativave të prodhimit, në identifikimin e mundësive të reja të tregut dhe në ofrimin e projekteve të tyre huadhënësve, partnerëve të biznesit ose familjes së tyre. Ekzistojnë forma të shumta të fermave, si ato familjare, kooperative, fermat e vogla, të mesme dhe të mëdha. Për nga natyra e prodhimit janë fermat konvencionale dhe ato me prodhimtari organike. Në procesin e tyre zhvillimor fermat kalojnë nëpërmjet tri faza kryesore: fermat e vetëmbajtjes, që prodhojnë ushqim vetëm për nevojat e familjes së fermerit; fermat e kombinuara, që prodhojnë ushqim për nevojat e familjes dhe një pjesë për treg dhe fermat familjare tregtare, ose fermat e specializuara për treg. Ferma është ndër subjektet dominuese në bujqësinë e Kosovës. Numri i tyre vlerësohen të jetë rreth 100,000 ku mbi 80% e tyre janë fermat vetëmbajtëse, rreth 15% janë ferma gjysmëkomerciale dhe me pak se 5% janë ferma komerciale. Problemet më të mëdha të fermave bujqësore në Kosovë janë pajisja e dobët me mjetet e punës, kushtet shumë të pavolitshme të financimit, numri i madh i fuqisë punëtore të përqendruar në fermë, përmasat e vogla të fermës dhe mangësitë në grumbullimin e tepricave të produkteve bujqësore, si dhe zhvillimi i pamjaftueshëm i tregjeve për këto produkte në nivelin lokal, rajonal dhe qendror. (Halim Gjergjizi)

FEROVIQ (Ferović) Abedin (1935-2010). Jurist, profesor universitar. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin, ndërsa Fakultetin Juridik e kreu në Beograd.

Në vitin 1963 u zgjodh asistent dhe më pas ligjërues dhe profesor për lëndën sistemi politik në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1980). Ishte prodekan dhe dekan i Fakultetit Juridik, sekretar ekzekutiv i Kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, anëtar i grupit punues të Komisionit Kushtetues të Jugosllavisë, anëtar i Kryesisë së Sindikatave dhe anëtar i Komitetit Krahinor të LK të Kosovës. Kreu edhe detyra të tjera në institucionet e arsimit të lartë. Në vitin 1999 u zhvendos në Novi-Pazar dhe u zgjodh dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Ndërkombëtar të themeluar në këtë qytet. Vdiq në Prishtinë. (Nerxhivane G. Dauti)

FERRI Hasan (1860-1946). Luftëtar, tribun popullor i krahinës së Plavës e Gucisë. Ishte i biri i Jakup Ferrit. Mori pjesë në Kuvendin e Junikut më 1912. Ishte përfaqësues i krahinës së Plavës dhe Gucisë dhe njëri nga organizatorët kryesor për mobilizimin e shqiptarëve në Plavë, Guci, Pejë, Gjakovë etj. gjatë kryengritjes së viteve 1910-1912. Pas vitit 1913 dhe mbetjes së Plavës dhe Gucisë nën sundimin malazez, organizoi qëndresën kundër ushtrisë malazeze. Ishte pjesëmarrës i rezistencës së shqiptarëve kundër forcave të intervenimit ushtarak jugosllav në Shkodër. H. Ferri përkrahu Nolin dhe mori pjesë në kryengritjen e qershorit të vitit 1924. Pas rikthimit të Zogut në pushtet, H. Ferri u burgos dhe vuajti dënimin në burgun e Shkodrës. Pas amnistisë, në vitin 1929 u rreshtua përkrash forcave që organizuan Kongresin e Lushnjës. Duke parë të pamundur kthimin e tij në Plavë dhe qëndrimin në Shqipëri, emigroi në Turqi. U vendos në Izmir, ku kaloi vitet e fundit të jetës. (Jusuf Bajraktari)

FERRI Jakup (1832-1880). Prijës popullor, luftëtar për çlirim kombëtar dhe mbrojtjen e tokave shqiptare. Lindi në Plavë. Tre vëllezërit e tij ranë në luftë kundër forcave pushtuese të



JAKUP FERRI

Malit të Zi. J. Ferri ishte pjesëmarrës aktiv në kryengritjet në krahinën e Plavës dhe Gucisë që nga koha e Reformave të Tanzimatit. Më pas organizoi çetat vullnetare për të mbrojtur trevat shqiptare nga depërtimi i ushtrisë malazeze. Bash-

kë me Ali pashë Gucinë u shqua si njëri nga personalitetet e rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte njëri nga pjesëmarrësit dhe organizatorët që iu kundërvunë forcave të Mehmet Ali pashë Maxharrit në Gjakovë në shtator të vitit 1878. Më pas vazhdoi aktivitetin luftarak në territorin e vilajetit të Kosovës dhe atë të Shkodrës. Në dhjetor 1879 udhëhoqi forcat shqiptare të Lidhjes në luftë kundër malazezëve në afërsi të Nokshiqit dhe të Velikës. Në këto beteja ai doli fitimtar. Në njëren ngjë këto përballje, afër lumit Lim, J. Ferri u vra më 11 janar 1880. Pas vrasjes së Jakupit i biri i tij Hasan Ferri u bë kryefamiljar dhe personalitet i respektuar i cili vazhdoi rrugën e të atit. (Jusuf Bajraktari)

FERRI Jakup (1981-). Pikturor. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesën, ndërsa studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë dhe në “Rijksakademie” në Amsterdam. Disa prej ekspozitave personale të Ferrit janë: “Hapësirë kryengritëse” në Tiranë (2006); “Tri virgjëresha”, Galerie Adler, Frankfurt (2006); “Dy virgjëresha”, Karlsruhe (2009); “Sot në histori”, Bukuresht (2009); pastaj “Punime në letër” në “Galerie De Meerse”, Hoofddorp (Holandë), në “Galerie De Expediti” në Amsterdam; “Vizatime xhepi në kornizë” gjithashtu në Amsterdam (2010); “Cekirdek në vend të Leblebi”, Outlet Istanbul (2010); “Uji i ftohtë vlon më shpejt”, gjithashtu në Amsterdam (2013), si dhe disa ekspozita të tjera me karakter ndërkombëtar. J. Ferri është fitues i çmimit “Muslim Mulliqi” në Prishtinë (2003), i çmimit “Artistët e së nesërme” gjithashtu në Prishtinë (2003), i çmimit “E ardhmja e Europës” nga Muzeu për Art Bashkëkohor në Lajpcig (2006) dhe i çmimit “Buning Brongers Prijzen” në Amsterdam (2008). Jeton dhe krijon në Amsterdam të Holandës. (Ilir Muharremi)

FERRI Naser (1955-). Arkeolog. Lindi në Pejë dhe kreu arkeologjinë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit (1978), ku mbaroi edhe studimet pasuniversitare. Doktoroi në Universitetin e Prishtinës (1997). Në vitin 1979 filloi punën në Institutin Albanologjik në Prishtinë dhe gjatë viteve 1996-2002 ishte udhëheqës i degës së historisë në këtë Institut. Më 1999 ishte drejtor i Muzeut të Kosovës. U zgjodh këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik



NASER FERRI

ës, ku u zgjodh profesor i rregullt për lëndët mitologji dhe histori e etnologjisë (2004). Bëri specializime dhe vizita shkencore në Romë, Muni, Budapest, Lubjanë etj. dhe mori pjesë me kumtesa në shumë kongrese, konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare. Ish-te redaktor dhe bashkautor i monografive të Tërnocit të Madh e të Pejës dhe anëtar i Shoqatës së Arkeologëve të Sllovenisë. Botoi librat “Statusi shoqëror-ekonomik i të liruarve në provincën romake Moeisa Superior”, “Monumentet e ushtrisë romake në Mezi të Epërme” dhe “Mythologia viva” (2012), e përkthyer kroatisht (2015). Ka botuar punime të shumta shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Haxhi Mehmetaj)

FERRI Rexhep (1937-). Pikturor, shkrimtar, akademik. Lindi në Kukës (Shqipëri). Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa u diplomua në degën e pikturës monumentale



REXHEP FERRI

në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1966), ku më pas kreu studimet pasuniversitare. Në vitin 1974 u zgjodh ligjërues në Akademinë e Arteve në Prishtinë, ku vazhdoi punën deri në pensionim (2002). Qe pedagog i angazhuar në Universitetin e Tetovës në vitet 1995-2004. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga themelimi. Më 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt. I takon brezit të parë të artistëve pamorë të Kosovës, i cili me dekada ndërtoi fizionominë e tij si krijues. Tematika e veprave të tij karakterizohet si rrugëtimi i njeriut në drejtime dhe caqe të caktuara, pa marrë parasysh nëse lëvizjet e tij janë individuale apo grupore. Në të shumtën e rasteve ato shprehin

(2003) dhe ligjërues në Fakultetin e Filologjisë në Gjakovë. Më parë ishte i angazhuar mësimdhënës i jashtëm në degën e historisë (1998) dhe një periudhë në degën e etnologjisë (2001) të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës,

ku u zgjodh profesor i rregullt për lëndët mitologji dhe histori e etnologjisë (2004). Bëri specializime dhe vizita shkencore në Romë, Muni, Budapest, Lubjanë etj. dhe mori pjesë me kumtesa në shumë kongrese, konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare. Ish-te redaktor dhe bashkautor i monografive të Tërnocit të Madh e të Pejës dhe anëtar i Shoqatës së Arkeologëve të Sllovenisë. Botoi librat “Statusi shoqëror-ekonomik i të liruarve në provincën romake Moeisa Superior”, “Monumentet e ushtrisë romake në Mezi të Epërme” dhe “Mythologia viva” (2012), e përkthyer kroatisht (2015). Ka botuar punime të shumta shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Haxhi Mehmetaj)

realitetin e ankthit, vetminë, ikje-kthimin etj. Nga ekspozitat e mëvetësishme në Kosovë, në ish-Jugosllavi dhe në vende të ndryshme të Europës veçohen: më 1968 në Beograd, më 1969 në Vicenza (Itali), më 1976 sërish në Beograd, më 1977 në Paris, më 1982 në Prishtinë, më 1981 në Sarajevë, më 1989 në Ankara, më 1995 në Ulqin, më 2001 dhe 2013 në Tiranë, më 2012 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në Prishtinë etj. Gjithashtu mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta të organizuara nga SHAFK-u dhe Shoqata e Artistëve Aplikativë të Kosovës, në vend dhe jashtë, si dhe në shumë veprimtari të tjera artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Bienalen e Mesdheut në Aleksandri (1972), në ekspozitën e përbashkët “Arti bashkëkohor i Kosovës” në Muni (1985); në ekspozitën “Arti modern kosovar” në Paris (2007) etj. Është fitues i disa mirënjohjeve dhe i çmimeve në manifestimet vendore dhe kombëtare, në fushën e arteve figurative dhe të letërsisë. Veprat e tij gjenden në shumë institucione, në koleksione private, në muze e galeri, në Kosovë dhe jashtë. R. Ferri botoi disa libra me poezi: “Këmisha e bardhë” (1984), “Trekëndëshi me detin” (1988), “Ndoshta ishte dashuri” (1997), Portreti i një vetmie (2003) etj., pastaj romanet: “Atdheu im torzo” (1998), “Frikë nga Gernika” (2004), “Shapo Albanë” (2006), “Britma e Munkut” (2011) etj., si dhe monografi dhe tekste të shumta eseistike. (Hivzi Muharremi)

realitetin e ankthit, vetminë, ikje-kthimin etj. Nga ekspozitat e mëvetësishme në Kosovë, në ish-Jugosllavi dhe në vende të ndryshme të Europës veçohen: më 1968 në Beograd, më 1969 në Vicenza (Itali), më 1976 sërish në Beograd, më 1977 në Paris, më 1982 në Prishtinë, më 1981 në Sarajevë, më 1989 në Ankara, më 1995 në Ulqin, më 2001 dhe 2013 në Tiranë, më 2012 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në Prishtinë etj. Gjithashtu mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta të organizuara nga SHAFK-u dhe Shoqata e Artistëve Aplikativë të Kosovës, në vend dhe jashtë, si dhe në shumë veprimtari të tjera artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Bienalen e Mesdheut në Aleksandri (1972), në ekspozitën e përbashkët “Arti bashkëkohor i Kosovës” në Muni (1985); në ekspozitën “Arti modern kosovar” në Paris (2007) etj. Është fitues i disa mirënjohjeve dhe i çmimeve në manifestimet vendore dhe kombëtare, në fushën e arteve figurative dhe të letërsisë. Veprat e tij gjenden në shumë institucione, në koleksione private, në muze e galeri, në Kosovë dhe jashtë. R. Ferri botoi disa libra me poezi: “Këmisha e bardhë” (1984), “Trekëndëshi me detin” (1988), “Ndoshta ishte dashuri” (1997), Portreti i një vetmie (2003) etj., pastaj romanet: “Atdheu im torzo” (1998), “Frikë nga Gernika” (2004), “Shapo Albanë” (2006), “Britma e Munkut” (2011) etj., si dhe monografi dhe tekste të shumta eseistike. (Hivzi Muharremi)

FERRI Samka (1953-). Kostumografe. Lindi në Pejë, ku përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm, kurse studimet i mbaroi në Shkollën e Lartë të Tekstilit dhe të Veshjes të Universitetit të Zagrebit (1976). Puno



SAMKA FERRI

si kostumografe në Televizionin e Prishtinës prej vitit 1977 deri në vitin 1990, kur Serbia i dëboi punëtorët shqiptarë nga ky institucion. Ka punuar kostumet për një sërë projektsh filmike dhe teatrore, ku shquhen kostumet për filmat artsitkë: “Tre vetë kapërcejnë malin”, “Agnus Dei” etj., pastaj kostumet për shfaqjet “Babai” dhe “Fluturimi mbi folenë e qyqes”. Ndërkohë realizoi kostumet edhe për në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës: “Endrra e qenit”, “Shfaqja e fundit”,

të Zagrebit (1976). Puno si kostumografe në Televizionin e Prishtinës prej vitit 1977 deri në vitin 1990, kur Serbia i dëboi punëtorët shqiptarë nga ky institucion. Ka punuar kostumet për një sërë projektsh filmike dhe teatrore, ku shquhen kostumet për filmat artsitkë: “Tre vetë kapërcejnë malin”, “Agnus Dei” etj., pastaj kostumet për shfaqjet “Babai” dhe “Fluturimi mbi folenë e qyqes”. Ndërkohë realizoi kostumet edhe për në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës: “Endrra e qenit”, “Shfaqja e fundit”,

“Shtëpia e Bernarda Albës”. Punoi edhe kostumet për shfaqjet e Baletit të Kosovës, ku do veçuar “Balloja e diplomës”, “Fluturimi drejt dritës” etj. Për kontributin e dhënë në Teatrin Kombëtar të Kosovës u nderua me Pllakatin e Artë (2012) nga ky institucion, ndërsa mori një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh për punë të suksesshme artistike. Punon si kostumografe e përhershme në Teatrin Kombëtar të Kosovës. (Besim Rexhaj)

FERRI Shaban (1892-1990). Veteran i arsimit. Lindi në Plavë. Shkollën fillore e kreu në Mitrovicë, ndërsa normalen në Elbasan. Në vitet 1923-1934 ishte mësues në shkollën fillore të Tropojës, ndërsa më vonë, deri në vitin 1939, ishte mësues në Kukës, Zapot dhe Shishtavec. Një vit ishte mësues edhe në Sarandë. Në prill të vitit 1941 kthehet në vendlindje dhe angazhohet për çeljen e shkollave shqipe në komunën e Plavës. Po atë vit arriti të çelë shkollat fillore në Plavë, përkatësisht në Guci, të cilat punuan pa ndërprerje deri në vitin shkollor 1943/44. Për kontributin në zhvillimin e arsimit në Malësinë e Tropojës, në vitin 1979 u dekorua me urdhrin “Naim Frashëri”. (Palokë Berisha)

FESTIVALET E FILMIT. Manifestime kulturore që filluan të organizohen në Kosovë pas vitit 2000, në të cilat prezantohen realizimet më të reja në kinematografinë vendore ose të huaj. Shumica e këtyre festivaleve nuk kanë pasur qëndrueshmëri, për shkak të tregut të kufizuar të filmit të huaj që paraqet Kosova dhe të prodhimit të pamjaftueshëm vendor. Deri më tani janë organizuar disa festivale të këtilla, ndër të cilët më të njohurit janë:

Festivali “Dokufest”, festival ndërkombëtar i filmit të shkurtër dhe dokumentar, i cili nga viti 2002 çdo verë mbahet në Prizren, në periudhën 16-24 gusht. Është festivali më i rëndësishëm ndërkombëtar që organizohet në Kosovë. Në kuadër të tij shfaqen shumë filma dokumentarë dhe artistikë, në ambiente të hapura në qytetin e Prizrenit. Projeksionet e filmave kanë një numër të madh shikuesish dhe festivali ka arritur të çmohet si manifestimi më i mirë kulturor në Kosovë. Në festival marrin pjesë krijues filmikë nga shtetet e rajonit dhe më gjerë. Në vitin 2014 nga numri rekord prej 2,400 filmash që aplikuan, festivali përzgjodhi 237 filma, në kuadër të gjashtë programeve garuese dhe programeve speciale. Drejtor artistik është



PAMJE NGA FESTIVALI “DOKUFEST”, PRIZREN

Veton Nurkollari. Festivalin e përcjellin edhe një numër aktivitete, si punëtori, ekspozita, kampingu i festivalit, koncerte etj., duke i dhënë manifestimit karakter multikulturor.

Festivali “Skena UP”, festival ndërkombëtar i studentëve të filmit dhe teatrit, që mbahet çdo vit nga tetori i vitit 2003 në Prishtinë. I themeluar nga një grup studentësh dhe artistësh të rinj, Festivali “Skena UP” u bë platformë për garë të filmave dhe shfaqjeve të studentëve, që e bënë këtë festival të veçantë dhe të njohur.

Festivali “Pri-film-Fest”, festival ndërkombëtar i filmit, i cili nga viti 2009 mbahet në Prishtinë. Prezanton filmat e rajonit dhe më gjerë. Në hapjen e edicionit të parë të festivalit mori pjesë aktorja e njohur, Vanesa Redgrave. Shfaqen mbi 40 filma në shtatë programe. Drejtore e Festivalit është Vjosa Berisha.

Festivali 9/11, festival i filmit të shkurtër dhe dokumentar që u mbajt në Prishtinë. U themelua në vitin 2003, në shenjë kujtimi për viktimat e sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në Nju-Jork. Pjesa më e madhe e filmave që konkurruan në këtë revy filmike ishin të produksionit “Prishtina film”. Drejtor i festivalit ishte Blerim Gjocaj.

Festivali “Shqip Film Fest”, festival i filmave të shkurtër e dokumentarë. Drejtor ishte Naser Rafuna, pastaj Reshat Alija.

Festivali “Anibar”, festival ndërkombëtar i filmit të animuar, i pari i këtij lloji në Kosovë, që mbahet në Pejë. (Gani Mehmetaj)

FESTIVALI “AKORDET E KOSOVËS”. Festival i muzikës së lehtë ose argëtuese në Kosovë, i themeluar në vitin 1969. Me vite të tëra ka arritur të mbledhë krijues të muzikës,



NGA FESTIVALI “AKORDET E KOSOVËS”

kantautorë, interpretë, drejtues orkestre revyale, poetë nga më të njohurit e vendit. Shquhej si njëri ndër manifestimet më të rëndësishme muzikore të kësaj gjinie muzikore jo vetëm në Kosovë, por edhe në ish-Jugosllavi. Në të prezantoheshin këngë grupmoshash të ndryshme. Ishte i ndarë në tri mbrëmje muzikore: Mbrëmja e muzikës për fëmijë, Mbrëmja e muzikës popullore dhe Mbrëmja e muzikës argëtuese. Festivali ishte me karakter garues: interpretuesit më të dalluar merrnin çmime, kompozitorët gjithashtu, por edhe hartuesit e teksteve. Festivali vlerësohej si nga pjesëmarrësit, ashtu edhe nga njerëzit e kulturës, krijuesit në përgjithësi dhe nga publiku i gjerë. Në të janë prezantuar shumë kompozitorë, orkestrantë, këngëtarë e kantautorë që për vite me radhë kanë marrë pjesë aktivisht dhe janë shpërblyer. Midis tyre veçojmë kompozitorët: Gjergj Kaçinari, Tomor Berisha, Musa Piperku, Severin Kajtazi, Reshat Randobrava e të tjerë, si dhe interpretues të njohur si Nexhmije Pagarusha, Shpresa Gashi, Shahindere Bërlajolli, Sabri Fejzullahu, Bedri Islami e shumë të tjerë. Drejtor artistik i festivalit ishte kompozitori, dirigjenti e orkestruesi Kristë Lekaj. Në vitet '90, për arsye politike, ashtu si dhe shumë aktivitete të tjera artistike, edhe “Akordet” e ndërprehen punën. Më 2010 u ndërmor një nismë për të ringjallur festivalin, por pa sukses. (Kristina Palokaj-Perkola)

FESTIVALI “DAM”. Festival ndërkombëtar i muziktarëve të rinj, i themeluar nga një grup studentësh të degës së muzikës të Fakultetit të



NGA FESTIVALI “DAM”

Arteve të Universitetit të Prishtinës (D. Selimaj, M. Ferizi, A. Krasniqi, L. Ballata, Y. Rexhepi, B. Çerkini). Edicioni i parë që organizuar në prill të vitit 2006, si pjesë e aktiviteteve vjetore të Fakultetit të Arteve. Festivali ka mbledhur muziktarë të rinj dhe të talentuar kombëtarë e ndërkombëtarë. Edicioni i dytë i këtij festivali u mbajt me një koncert përkujtimor në nderim të tenorit të famshëm L.Pavaroti (2007). Shumë vepra të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj janë ekzekutuar për herë të parë në këtë festival dhe janë prezantuar ansamble e solistë të njohur vendorë e të huaj. (Arnisa Rexhepi)

FESTIVALI “DITËT E MUZIKËS KOSOVARE”. U themelua më 1979 nga Shoqata e Kompozitorëve e Kosovës për të prezantuar krijimtarinë muzikore të kompozitorëve vendorë e kombëtarë. Në vitet 1979-1991 festivali u zhvillua në Gjakovë. Gjatë atij dhjetëvjetëshi janë realizuar 209 vepra korale, solistike instrumentale, kamerale, vokalo-instrumentale, orkestrale dhe muzikore-skenike. Gjithashtu janë organizuar tryeza muzikologjike me rastin e përvjetorëve të anëtarëve. Për shkak të ndërprerjes të aktivitetit të Shoqatës, në periudhën 1992-2010 u ndërpre edhe veprimtaria e Festivalit. Pas vitit 2011, krahas aktivitetit tjetër muzikor, janë bërë përpjekje që Festivali të riaktivizohet sërish. (Zeqirja Ballata)

FESTIVALI “HASI JEHON”. Festival folklorik. Mbahet në Gjonaj të Hasit që nga viti 1976. Konsiderohet se ka dhënë një kontribut të madh në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike të mbarë trevave shqiptare. Në këtë festival kryesisht prezantohen shoqëri kulturore-artistike, interpretues të ndryshëm, me këngë e valle tradicionale, me instrumente popullore

dhe veshje të trevave të larmishme shqiptare, si dhe doke e zakone autoktone. Festivali rëndom organizohet në tri mbremje dhe nuk ka karakter garues, megjithatë ka një juri profesionale, e cila në çdo edicion të festivalit bën vlerësimin e prezantimeve më të kompletuara në nivelin artistik. (Kristina Palokaj-Perkola)

FESTIVALI “KAMERFEST”. Festival i muzikës kamerale ansamblesh dhe solistësh të huaj e vendorë. Edicioni i parë i këtij festivalit është realizuar në vitin 2000, me prezentimin



e violinistit të njohur shqiptar Tedi Papavrami dhe që atëherë vijon pandërprerë. Drejtore artistike e festivalit është violinistja dhe pedagogia e shquar Sihana Badivuku. Festivali organizohet nga fondacioni “Ars-Kosova”. Qëllimi kryesor i tij është prezantimi dhe bashkëpunimi me ansamblet e njohura nga vende të ndryshme europiane e më gjerë, realizimi i veprave të kompozitorëve të huaj dhe vendorë dhe këmbimi i përvojave mes artistëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe në “Kamerfest” kanë marrë pjesë me vepra nga më të ndryshme autorë të huaj dhe vendorë, ansamble dhe emra të shquar të muzikës artistike nga vendi dhe bota (Besa Luzha)

FESTIVALI “PIANISTI I RI”. Festival që synon të promovojë talentët e rinj të pianos në Kosovë. U themelua më 2008 nga Shoqata e pianistëve “Bell’arte Kosova”, me nismën e V. Barutit, L. Haxhiu-Pula dhe V. Petrovcit. Edicioni i parë (2008) u realizua në Mitrovicë, seli e festivalit jогarues “Takimet e talentëve”. Deri tash është i vetmi festival i përvitshëm garues i profilizuar në Kosovë për nxënës e studentë të pianos (mosha 4-19-vjeçare).



PAMJE NGA FESTIVALI “PIANISTI I RI”

Katër edicionet e para (2008-2011) ishin me karakter kombëtar, nga edicioni i 5-të (2012) është ndërkombëtar, si në aspektin e përbërjes së jurisë, ashtu dhe të pjesëmarrësve. Garuesit që u dalluan janë: M. Bërveniku, M. Sefa dhe B. Milla (Kosovë), M. Halqe (Turqi/ Kosovë), N. Grubi (Maqedoni), etj. Festivali, përpos tri çmimeve të para, ndan dhe çmimin special “Pianisti i ri” (koncertim me Filarmoninë e Kosovës) dhe siguron pjesëmarrje në festivalin ndërkombëtar në Kaunas (Lithuani). Rritja e interesimit për Festivalin shënohet në shkollat e Kosovës dhe në pjesëmarrjen e pianistëve nga shtete të tjera. (Indira Çipa)

FESTIVALI “SKENA MUZIKORE E PRISHTINËS”. U themelua më 1974 për nder të ditës së çlirimit të Prishtinës. Ishte festival i përvitshëm muzikor, që u mbajt me nismën e disa kompozitorëve të Kosovës dhe të Bashkësisë së Kulturës të komunës së Prishtinës, Bashkësisë Kulturore-Arsimore të Prishtinës dhe Radiotelevizionit të Prishtinës. Kujdes iu kushtua veprave të kompozitorëve kosovarë (L. Antoni, R. Mulliqi, M. Kaçinari, F. Beqiri, E. Rizvanolli, A. Koci, Z. Ballata, V. Gjini, R. Dhomi, R. Rudi etj.). Kanë marrë pjesë Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit të Prishtinës, Kori “Collegium cantorum”, studentë të përzgjedhur nga Akademia e Arteve, solistë të tjerë e ansamble kamerale, korale, orkestrale nga qendrat e ish-Jugosllavisë, por edhe nga vendet fqinje dhe më gjerë. Festivali ka pasur një ndërprerje të gjatë (1992-2001) për shkak të rrethanave politike në Kosovë. (Zeqirja Ballata)

FESTIVALI “SHOPEN PIANO FEST”. U themelua në vitin 2009, fillimisht duke iu



përkushtuar para së gjithash veprave të pianistit dhe kompozitorit të njohur romantik, Frederik Shopen. Më pas ka filluar t'i zgjerohet aktivitetet edhe përmes pjesëmarrjes së solistëve dhe grupeve të ndryshme ansambleske, vendore e të huaja, me vepra të ndryshme solistike, kamerale, por dhe orkestrale. Festivali i kushtohet prezantimit të pianistëve me repertorë të ndryshëm dhe të larmishëm të literaturës pianistike, por dhe të veprave të tjera solistike e kamerale të kompozitorëve botërorë dhe atyre shqiptarë në përgjithësi. I udhëhequr nga pianistja Lejla Pula dhe në organizim të Besa Luzhës, ky festival ka organizuar në vazhdimësi edicione të suksesshme me pianistë të shquar vendorë e botërorë. (Zeqirja Ballata).

FESTIVALI “ZAMBAKU I PRIZRENIT”.

Festival tradicional i këngës qytetare me karakter garues. U themelua në vitin 1986 nga subjektet kulturore të qytetit të Prizrenit, Shoqata



NJË EDICION I FESTIVALIT “ZAMBAKU I PRIZRENIT”

e Kompozitorëve e Kosovës dhe Produksioni i Radiotelevizionit të Prishtinës. Qëllimi ishte ruajtja, kultivimi dhe pasurimi i këngës

qytetare. Festivali është pasuruar me forma e shprehje muzikore, ka ruajtur brendësinë e zhanrit. Në të kanë marrë pjesë krijues e interpretues të njohur, janë afirmuar kompozitorë, këngëtarë e orkestrues. Njëkohësisht ai kishte për qëllim zbulimin dhe promovimin e emrave të rinj muzikorë. Realizimi i edicioneve të Festivalit është ndërprerë gjatë okupimit të Kosovës dhe më pas. Më 2015 u realizua edicioni i 27-të. Festivali sot i takon komunës, ndërsa ndër bartësit e organizimit është dhe Shoqëria kulturore-artistike “Agimi”. Në festival ndahen çmime të jurisë dhe të publikut. Karakteristikë e festivalit është se ai mbahet në javën e dytë e të tretë të qershorit, kur lulja e zambakut është në fazën e lulëzimit. (Indira Çipa)

FESTIVALI I FOLKLORIT KOMBËTAR, GJIROKASTËR.

Është ngjarja më e madhe etnokulturore shqiptare. Festivali mbahet në kalanë e qytetit të Gjirokastrës. Manifestimi ka për qëllim prezantimin e etnosit shqiptar nga të gjitha vendet ku jetojnë shqiptarët. Të sinkretizuara, aty prezantohen veshjet kombëtare shqiptare, vallet, këngët, instrumentet muzikore, ritet, doket e zakonet me qëllim që këto vlera të kultivohen dhe të ruhen. Festivali organizohet çdo pesë vjet dhe për herë të parë u mbajt në vitin 1968. Më pas festivali u mbajt edhe në vitet 1973, 1978, 1983 dhe në vitin 1988, për t'u zhvendosur në Berat në vitin 1995 dhe për t'u rikthyer në Gjirokastrë në vitet 2000, 2004, 2009 dhe 2015. Grupet pjesëmarrëse në festival vijnë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë, ndërsa Kosova dhe shqiptarët që jetojnë në vendet fqinje prezantohen me grupet e tyre (2-3 grupe nga Kosova dhe 3-4 syresh nga Maqedonia, Mali i Zi, Greqia etj). Përzgjedhja e grupeve pjesëmarrëse bëhet nga juritë profesionale, të cilët vizitojnë rajonet e paracaktuara dhe zgjedhin programin më të mirë dhe më përfaqësues, me qëllimin që të sjellin vlera sa më përfaqësuese të zonave etnografike shqiptare. Në fund nga juria profesionale ndahen edhe çmimet për grupet dhe individët me paraqitje më të mirë në festival. (Visar Munishi)

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR “RE-MUSICA”.

Ka dalë nga festivali “Skena Muzikore e Prishtinës”. Vitin e parë të riaktivizimit më 2002 e ndryshoi emërtimin në “Skena e re muzikore e Prishtinës”. Një vit më pas u emërtua



NGA FESTIVALI "REMUSICA"

Festivali Ndërkombëtar "Re-Musica", të cilin e mban dhe sot, udhëhequr nga kompozitori e dirigjenti Rafet Rudi. Festivali ka një koncept të orientuar drejt veprave bashkëkohore të autorëve nga Kosova dhe Shqipëria, por edhe të kompozitorëve të njohur bashkëkohorë nga vendet europiane, Amerika e deri te Japonia. Ky orientim vlen edhe në angazhimin e interpretëve instrumentalë dhe vokalë dhe të ansambleve kamerale, si dhe ato vokalo-instrumentale formacionesh më të vogla, por të afirmuar. Gjatë viteve 2002-2015 janë ekzekutuar shumë vepra, sidomos solistike-instrumentale e vokale, kamerale, korale e vokalo-instrumentale, gjithnjë me theks tek autorët bashkëkohorë nga Kosova dhe Shqipëria, por edhe të huaj. Veprat nga më të ndryshmet, orientimesh, teknikash e shprehjesh bashkëkohore i kanë realizuar solistë e formacione ansamblesh instrumentale, korale (Kori i Filarmonisë së Kosovës, i prirë nga vetë udhëheqësi i tij R. Rudi), si dhe ansamble vokalo-instrumentale. (Zeqirja Ballata)

FETAHAJ Jonuz (1946-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Rahovicë të Preshevës, ku filloi mësimet e para, për t'i vazhduar më pas në Preshevë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe



JONUZ FETAHAJ

i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor në revistën "Shkëndija". Gjithashtu, ishte kryeredaktor i revistave "Bujku" e "Pionieri" dhe drejtor i revistave të ndërmarrjes "Rilindja". Shkruan poezi dhe prozë për fëmijë dhe të rritur. Botoi një sërë veprash letrare dhe

është bashkautor i disa monografive. Veprat e botuara: "Shtegtime" (1970), "Pavdekshmëri" (1979), "Lumi i pa gjumi" (1982), "Kohës i ranë dhëmbët" (1995), "Gjyshi frajer" (1996), "Përtej ëndrrës" (1997), "Zogiliri" (1998), "Vezët e qyqes" (1998), "Udhëtimi pas mjegullës" (2000), "Zogu pa pasaportë" (2003), "Gjyshja mbretëreshë dhe princi në shtëpi" (2005), "I biri i Rozafës" (2007), "Nuk është jeta cimilim" (2008), "Vetmi e bukur" (2008), "Malli i zbardhur" (2008), "Udhëtimi i parë" (2008), "Drita në shkëmb" (2008), "Lojë në ferik" (2008), "Ku banon malli" (2009), "Kurrë harrim" (2009), "Sizifit nuk ia di varrin" (2009), "Shtëpia e erës" (2010), "Virusi i gjyshit" (2010), "Harta e lotit" (2011), "Lirikë me brymë" (2012) etj. Është redaktor në revistën "Pionieri". (Munish Hyseni)

FETAHAJ Xhemajl (1964-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Raushiq të Pejës. Kreu Shkollën e Mesme Ekonomike në Pejë, ndërsa studimet i vazhdoi në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë. Në janar të vitit 1984 u burgos dhe u dënua me 6 vjet burg. Pas liritimit nga burgu (1988) u angazhua në aksionin për pajtimin e gjaqeve. Në vitet '90 emigroi në Gjermani, ku u përfshi në strukturat e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) dhe të Fondit "Vendlindja Thërret". Me fillimin e luftës në Kosovë, u rreshtua në radhët e UÇK-së. Pasi i bashkëngjitet këtij fronti në Koshare, mori detyrën e komandantit të forcave komando "Delta". Më 31 maj 1999 ra heroikisht në krye të detyrës. Më 2012 nga presidentja e Kosovës u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Teuta Shala-Peli)

FETAHU Feriz (1949-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Koshtovë të komunës së Leposaviqit. Punoi në Obiliq, në Trepçë dhe në Mbrojtjen Territoriale të Mitrovicës. Ishte oficer rezervë i ushtrisë jugosllave, anëtar i shtabit të mbrojtjes territoriale të Mitrovicës dhe komandant i brigadës në Trepçë. Në vitin 1986 u burgos dhe u dënua për shkaqe politike. Në vitin 1990 u largua nga puna dhe mori pjesë aktivisht në veprimtaritë politike dhe sindikale. Ishte pjesëmarrës i luftë së UÇK-së në Zonën Operative të Shalës. Me themelimin e Brigadës 141 "Mehë Uka", u emërua ndihmëskomandant

i operativës. Këtë detyrë e kreu deri në mbarim të luftës. (Emin Musa)

FETAHU Shukri (1955-). Agronom, profesor universitar. Lindi në Letovicë, komuna e Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Preshevë, Fakultetin e Bujqësisë



SHUKRI FETAHU

në Prishtinë (1979). Studimet pasuniversitare gjithashtu i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin Bujqësor të Tiranës (2001). Pranohet asistent në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së për lëndën e gjenetikës dhe më vonë bëhet profesor i rregullt i këtij Fakulteti. Në kuadër të Institutit Bioteknik në Pejë punoi në krijimin e linjave të reja të misrit dhe të grurit (1999-2014). Ka qenë udhëheqës i disa projekteve shkencore. Është themelues i Bankës Gjenetike të Resurseve Bimore të Kosovës (2004), udhëheqës i grupit hulumtues të drithërave dhe të misrit. Për qëllime studimore ka qëndruar në disa universitete të jashtme. Ka qenë prodekan dhe dekan i Fakultetit të Bujqësisë të UP-së. Ka marrë pjesë me kumtesa në tubime dhe ka publikuar punime shkencore e profesionale dhe tekste universitare ("Gruri"; "Bioteknologjia" dhe "Bujqësia organike", bashkautor). (Bashkim Kabashi)

FETAJ Shaban (1949-). Mjek, internist, reumatolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Strellc të Deçanit. Në vitin 1968 migroi në Gjermani, punoi si punëtor krahu derisa e mësoi



SHABAN FETAJ

mirë gjuhën gjermane dhe punësohet në spital si infermier. Në Gjermani kreu maturën në vitin shkollor 1974/75. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Hajdelbergut në vitin 1981. Pas mbarimit të studimeve, punoi si mjek në Spitalin Akademik të Bohumit. Specializoi për mjekësi interne, reumatologji dhe fizioterapi me rehabilitim. Prej vitit 1991 kaloi në Vlotho, në Klinikën "Weserland", ku u emërua kryemjek

dhe më pas shef i repartit internistik dhe reumatologjik. Në vitin 1995 emërohet shef i Klinikës Weserland. Ndërkohë u subspecializua edhe në fushën e gjeriatrisë dhe të mjekësisë natyrore. Është këshilltar i Institutit për Terapi Fizikale dhe anëtar i Shoqatës së Internistëve dhe Reumatologëve Gjermanë dhe udhëheqës i projektit për rehabilitim në reumatologji në Qendrën e Reumatologjisë në Bielefeld. Ka botuar shumë punime shkencore dhe profesionale. Në Kosovë ka bërë disa vizita, ka mbajtur ligjërata si profesor i ftuar dhe ka marrë pjesë në simpoziume dhe kongrese të internistëve dhe reumatologëve kosovarë. (Ismajl Dreshaj)

FETAJ-BERISHA Vlorë (1969-). Mbledhëse dhe studiuese e folklorit. Lindi në Pejë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë. Kreu studimet e larta për gjuhë dhe letërsi shqipe dhe studimet pasuniversitare në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Qendrën për Studime Albanologjike në Tiranë. Punoi në Muzeun e Kosovës si bashkëpunëtorë profesionale në sektorin e etnologjisë (2002-2011) dhe më pas në degën e folklorit në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Ka marrë pjesë me kumtesa në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe ka të botuara disa punime studimore dhe artikuj në revista shkencore dhe në periodikun letrar. Vepra e saj më e rëndësishme është monografia "Ritet e lindjes dhe të vdekjes në rrethinën e Deçanit" (2011). (Ylberza Halili)

FETIU Sadri (1942-). Mbledhës dhe studiues i folklorit dhe i letërsisë. Lindi në Peqan të Suharekës. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin Filozofik të UP-së (1965). Stu-



SADRI FETIU

dimet pasuniversitare i kreu në Prishtinë, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1987). Punoi si gazetar dhe ishte mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Shkollën teknike "19 Nëntori" në Prishtinë. Në periudhën 1977-2007 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e folklorit, këshilltar shkencor dhe drejtor i këtij institucioni (në vitet 1991-2007). Botoi vepra nga fusha e studimeve

të folklorit dhe të letërsisë: “Romani shqiptar i luftës” 91979), “Poetika e baladës popullore” (1987), “Balada popullore shqiptare, aspekte krahasimtare” (1987), “Folkloristikë” (2009), “Aspekte të studimeve albanologjike” (20012). Ka përgatitur për botim vëllimet me lëndë folklorike “Ninullat” (1982), “Këngë e lojëra të fëmijëve” (1983) dhe ka bashkëpërgatitur vëllimet “Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare” (1978), “Këngë kreshnike II” (1991), “Këngë popullore historike” I, II, III, IV (2007)” etj. Ka mbledhur materiale folklorike në shumë vise shqiptare të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi dhe ka marrë pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore nga fusha e folkloristikës shqiptare. Ka botuar përmblendhjen poetike: “Vargje satirike” (1998) dhe veprën me shkrime publicistike “Udhëkryqet e Kosovës” (2005). Ishte profesor i angazhuar për lëndët mitologji, folklor krahasimtar dhe letërsi për fëmijë në Universitetin e Prishtinës. (Adem Zejnullahu)

FETIU Sefedin (1943-2000). Shkrimtar, studiues i letërsisë. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Gjakovë, ndërsa studimet universitare dhe pasuniversitare për gjuhë dhe letërsi shqipe i ndoqi në Universitetin e Prishtinës. Aty mbrojti edhe temën e doktoratës. Punoi një kohë në arsim, pastaj u zgjodh punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e letërsisë. Botoi veprat: “Krijues dhe krijime” (1979), “Në humbëtitrat e kohës” (1980), “Vepra e Migjenit dhe kritika e saj” (1984), “Poetika e romanit shqiptar” (1992), “Alternativat e kuptimit” (1994), “Koha e zgjimit të gjakut” (1996). Shkroi prozë dhe studime e kritikë letrare. Ishte i orientuar në studimin e letërsisë moderne dhe asaj bashkëkohore shqipe. Vëmendje të veçantë i kushtoi studimit të veprës së Migjenit, si dhe interpretimit dhe poetikës së romanit shqiptar. (Kujtim Rrahmani)

FETOSHI Arben (1975-). Gazetar. Lindi në Prizren. Shkollën fillore e kreu në Bellacërkë të Rahovecit, gjimnazin në Rahovec dhe Lushnjë të Shqipërisë. Studioi për drejtësi në Universitetin e Prishtinës, ku kreu studimet pasuniversitare dhe vazhdoi studimet e doktoratës në shkencat e komunikimit dhe të gazetarisë. Gjatë luftës ishte pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Me gazetari

filloi të merret nga viti 1994. Bashkëpunoi me gazetën “Kombi” në Tiranë dhe revistat “Zëri” e “Koha ditore” në Prishtinë. Ka punuar në disa media vendore e ndërkombëtare, si Radio “Evropa e Lirë” në Pragë dhe Radio Kosova (RTK). Në periudhën 2009-2013 ishte drejtor i Radio Kosovës. (Rrahman Paçarizi)

FEUDALIZMI. Rend shoqëror, ekonomik dhe politik në Europën Perëndimore në kohën e mesjetës së hershme (shek. V-XI) dhe më pas deri në shek. XVIII-XIX, në Europën e Mesme, Lindore dhe Europën Juglindore. Nocioni feudalizëm fillimisht kishte kuptimin e sistemit të hierarkisë, në të cilin feudali, si zotërues i pronave të mëdha të tokave e shpërblente vasalin me një feud (lat. feudum) për punën që kryente. Feudali, nga ana e tij, i nënshtrohej një mbreti në shkëmbim të garantimit të statusit që kishte, si zot i tokave të tij. Vasalët, për nevojat vetjake, u jepnin tokë në shërbim vasalëve të tjerë (bujkrobërve), mbi supet e të cilëve binte prodhimi i përgjithshëm në feudalizëm. Bujkrobi trashëgoi skllavin e shoqërisë së mëparshme, por gëzonte të drejta më të mëdha se ai. Në këtë sistem, ata që kryenin detyra publike (ushtarake, apo civile), shpërbleheshin me tokë, të cilën e trashëgonin. Sistemi feudal ishte sistem gjithëpërfshirës, që përcaktonte autoritetin dhe të drejtat e pronësisë.

Në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare pronat e para feudale ndeshen së paku nga shek. VIII-X. Pronat feudale në Kosovë në mënyrë më të dokumentuar paraqiten në dy diploma të perandorit bizantin, Bazili II (1018-1020). Sipas këtyre diplomave perandori i konfirmonte kryepeshkopit të Ohrit dhe sufraganëve të tij numrin e parikëve dhe klerikëve si për kryepeshkopatën, ashtu edhe për peshkopatën vartëse. Në këtë kontekst përmendet edhe Peshkopata e Prizrenit dhe ajo e Lipjanit. Këto marrëdhënie u shtrinë edhe mbi baza laike, kur u zhvillua sistemi i pronieve në këtë perandori. Në trevat shqiptare sistemi i feudalizmit zgjati më tepër se në vendet europiane (afërsisht deri në fillim të shek. XX). (Ramiz Abdyli)

FIBULA. Kapëse prej metali. Përdorej për të mbërthyer veshjet në vend të pullave. U përdor dhe si stoli e veshjeve dhe kishte funksion apotropëik, për t’u mbrojtur nga “syri i keq”. Ishte në përdorim më shumë nga shek. XIV p.e.r. deri në mesjetë. Paraqitet në shumë kultura në

trajta të ndryshme, andaj janë të rëndësishme për përcaktim kronologjik, përkatësi etnike dhe ndikime. Në Iliri ishte më e përhapur fibula gjyslykore. Në territorin e Kosovës janë gjetur kryesisht në varre të epokës së hekurit, si në tumat e Shirokës dhe të Porodimes. (Arsim Havolli)

FIDA Haxhi (1939-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në fshatin Konjare të Dibrës. Shkollën fillore e kreu në Dibër, të mesmen (normalen) në Shkup (1958). Studioi artin figurativ në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shkupit, ndërsa në vitin 1966 diplomoi për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit. Magjistroi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Fillimisht ishte mësues në qytetin e Dibrës, pastaj në fshatin Semenish të Shkupit. Në vitin 1966 filloi të punojë si mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Shkollën normale “Zef Lush Marku” në Shkup, ku ishte edhe edukator konvikti. Karrierën e tij profesionale, që nga viti shkollor 1972/73 e zhvilloi në Akademinë Pedagogjike, përkatësisht në Fakultetin “Shën Kliment i Ohrit”, në Shkup, si mësimdhënës i metodikës së lëndëve të ndryshme. Ishte edhe bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Tetovës. Është autor tekstesh të shkollës fillore. (Myqereme Rusi)

FIDANOVSKI Slobodan (?-). Arkeolog serb. Lindi në Kragujevc, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Studimet për arkeologji i kreu në Universitetin e Beogradit, ku kreu edhe studimet pasuniversitare. Punoi fillimisht në Muzeun e Smederevës (1974), më vonë në Muzeun e Kosovës dhe aktualisht punon në Muzeun Kombëtar të Beogradit. Në cilësinë e kustosit në Muzeun e Kosovës dhe kontribut në gërmimin dhe studimin e lokaliteteve të periudhës romake të Kosovës, si në Gllamnik, Municipium DD, Velekincë, Ulpianë, Kastërc etj. Është autor i monografive “Qeramika romake e Ulpianës” (1990) dhe “Velekinca: nekropol i periudhës romake dhe i mesjetës së hershme” (2010), si dhe i një numër studimesh të botuara në organe dhe revista të ndryshme shkencore. (Arben Hajdari).

FIDLER Wilfrid (Wilfried Fiedler) (1933-). Gjuhëtar gjerman, njëri ndër albanologët më të rëndësishëm të hapësirës gjermanishtfolëse. Lindi në Oberfrohna, Kemnic, Gjermani.



VILFRID FIDLER

Shkollimin e mesëm e kreu në Saksen, ndërsa në vitet 1951-1955 i ndoqi studimet për sllavistikë dhe për filologji të tjera të Europës Lindore dhe Juglindore në Universitetin e Humboldt në Berlin. Pas vitit 1955 ishte bashkëpunëtor shkencor në Akademinë e Shkencave në Berlin. Bashkë me Erih Stokmanin (Erich Stockmann) mori pjesë në ekspeditën në Shqipëri. Nga viti 1959 ishte mësimdhënës për gjuhën, letërsinë dhe folklorin shqiptar në Berlin. Më 1959 qëndroi për qëllime hulumtimi në Shqipëri. Më 1961 doktoroi në fushën e ballkanologjisë në Universitetin e Humboldt. Ishte bashkëpunëtor shkencor në Komisionin e gjuhësisë (1963-1967) dhe në Institutin për Gjuhët dhe Kulturën Romane në Akademinë e Shkencave të Gjermanisë në Berlin (1967-1968). Bashkë me Oda Buholcin (Buchholz) drejtoi grupin hulumtues për ballkanistikë në kuadër të Institutit Qendror të Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave në Republikës Demokratike të Gjermanisë në Berlin (1968-1988). Më 1988 mbrojti tezën e habilitacionit në fushën e albanologjisë në Universitetin e Humboldt. Prej vitit 1989 dhe deri më 1998 ishte profesor i albanologjisë në Universitetin “Ludwig-Maximilian” në Munih. Më 1991 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Njihet ndër albanologët më të shquar. Veçohet gramatika deskriptive për gjuhën shqipe, të cilën e shkroi në bashkëpunim me Oda Buholcin (“Albanische Grammatik”, Leipzig 1987). Bashkë me Buholcin dhe Gerda Ulishin (Uhlisch) hartoi Fjalorin shqip-gjermanisht, ndërsa bashkë edhe me Adrian Klosin, Fjalorin gjermanisht-shqip. Lista e tij e gjatë e studimeve nga fusha e albanologjisë dhe ballkanistikës përfshin monografitë “Sistemi foljor i gjuhës shqipe të Gjon Buzukut (1555)” (2004) dhe “Formimi i shumësit të gjuhës shqipe” (2010), botime të ASHAK-ut. Vepra e tij për sistemin foljor të gjuhës së Buzukut, në të vëtetë, është një monografi e gjerë (mbi 800 faqe) për gjuhën e këtij autori në tërësi, me një përqendrim te sistemi foljor. Monografia e tij për shumësin në gjuhën shqipe është rezultat i hulumtimeve prej disa dekadash dhe paraqet monografinë më të gjerë të shkruar ndonjëherë

për këtë çështje. V. Fidleri përktheu vepra të letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, ndër to “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe novela të I. Kadaresë, poezi të M. Camaj, poezi të A. Podrimjes. Punon profesor i jashtëm për gjuhë shqipe në Institutin për Studime për Europën Juglindore në Universitetin e Jenës “Friedrich Schiller”. (Milote Sadiku)

FILIPAJ Don Simon (1925-1999). Titullar i Kishës Katolike, përkthyes. Lindi në fshatin Kllezën e Poshtme, komuna e Ulqinit, në Mal të Zi. Më 1932 filloi shkollën fillore dyvjeçare në Selitë, e vazhdoi më pas në Katërkollë, po afër Ulqinit. Në periudhën 1939-1941 ndoqi seminarin e Tivarit dhe më pas Seminarin Jezuit në Shkodër (1941-1945). Në vitet 1946-1950 kreu studimet në Fakultetin e Teologjisë në Zagreb.



DON SIMON
FILIPAJ

U shugurua meshtar në vitin 1950 në Kryedioqezën e Tivarit. Fillimet e jetës klerikale Filipaj i kaloi në Triepsh e në Kojë të Kuçit (1950-1960), kurse në vitet 1960-1966 në Grudë të Malësisë së Madhe. Pjesën më të madhe të shërbimit, plot 33 vjet, e kreu në Shëngjergj, buzë lumit Buna, nga viti 1966 deri në fund të jetës. Në Shëngjergj iu kushtua përkthimit të teksteve biblike, përkatësisht “Ungjillit pas Mateut”, “Besëlidhja e re”, “Meshari romak” etj. Afro dyzet vjet ia kushtoi përkthimit dhe botimit në gjuhën standarde shqipe të Biblës së plotë (nga teksti Nova Vulgata), që u botua në Ferizaj në vitin 1994. Simon Filipaj gjithashtu u mor edhe me mbledhjen dhe botimin e folklorit shqiptar në Mal të Zi. Për kontributin e dhënë për Kishën Katolike, në vitin 1988 Selia e Shenjtë ia dha titullin e lartë “Imzot”, ndërsa më 6 korrik 1992 u shpall “Prelat Nderi” nga Papa Gjon Pali II. Për kontributin e tij në dobi të kulturës shqiptare, më 2004 (pas vdekjes) u dekorua nga presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhrin “Naim Frashëri”. (Frrok Kristaj)

FILIPOVIQ Vukashin (Vukašin Filipović) (1930-1990). Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, profesor universiteti, akademik. U diplomua për letërsi jugosllave në Fakultetin Filozofik në Beograd, ku më pas u doktorua (1964). Punoi si mësimdhënës në gjimnazin e



VUKASHIN
FILIPOVIQ

Prishtinës, në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe më pas profesor në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Një kohë ishte kryeredaktor i revistës “Stremljenja”. Botoi tregime, drama, romane, ese dhe studime. Botoi dramën “Borë dhe zjarr” (1963) dhe romanet “Gjurmët” (1957) dhe “Bregdeti i rrëpirët” (1961), si dhe një sërë librash me ese dhe studime të letërsisë serbe. Romani “Gjurmët” u përkthye në gjuhën shqipe (1958). Ishte anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga themelimi, ndërsa në periudhën 1986-1990 ishte kryetari i saj. U mor edhe me pikturë. (Ismet Marković)

FILOKSERA E HARDHISË (*Viteus vitifoliae*). Është insekt, morr, që dëmton hardhinë dhe bën pjesë në grupin e dëmtuesve karantinë i përhapur në Kosovë. Filoksera ka prejardhje nga Amerika dhe në Europë është shfaqur nga fundi i shek. XIX. I takon familjes *Phylloxeridae*, rendit krahnjëjtë - *Homoptera*. Insekti i rritur ka gjatësi 1.6-1.8 mm dhe gjerësi 1-1.2 mm. Ekzistojnë dy forma morfologjike-fiziologjike: forma që shfaqet në gjethë (*gallicolae*) dhe forma që shkakton deformime në rrënjë (*radicicolae*). Bima amvise natyrore e filokserës është hardhia (*Vitis vinifera*), e cila është shumë e ndjeshme ndaj formës rrënjore të insektit, por gjethet janë të qëndrueshme, ndërkaq hardhia amerikane *Vitis riparia* ka gjethë shumë të ndjeshme me gala ekstensive, por është shumë e qëndrueshme ndaj infektimit të rrënjëve. Llojet e tjera amerikane (*V. rupestris*, *V. berlandieri*) janë të qëndrueshme. Në llojet e hardhisë amerikane filoksera zhvillon cikël të plotë, jeton në gjethë dhe në rrënjë. Cikli i plotë i zhvillimit përfshin migrimin e insektit nga rrënjët në gjethë dhe përsëri në rrënjë dhe alternimin e shumimit në mënyrë partenogjeneze dhe seksuale. Si masë kryesore mbrojtëse ndaj filokserës përdoret shartimi i hardhisë së Europës në nënshartesa të qëndrueshme amerikane. (Latif Susuri)

FINANCAT PUBLIKE. Janë shpenzimet qeveritare si dhe mekanizmat që shfrytëzohen për të mbuluar këto shpenzime, veçanërisht tatimet dhe huatë. Financat janë të lidhura

me disa aspekte të shfrytëzimit të parave, me raportet monetare dhe me transaksionet në para, ndërsa pjesa e dytë e sintagmës, “publike”, do të thotë shtetërore. Në financat publike përfshihen të gjitha të hyrat publike dhe të dalat publike të buxhetit qendror dhe të buxheteve në nivel lokal. Të hyrat publike dhe të dalat publike duhet të jenë të baraspeshuara, që të mund të kryhet me sukses procesi i financimit publik dhe sigurimi i ofertës përkatëse të të mirave publike. Financimi buxhetor kërkon detyrimisht vendosjen e baraspeshës midis të hyrave publike dhe të dalave publike. Tri funksionet themelore të financave publike janë: alokimi, shpërndarja dhe stabiliteti. Funksioni i alokimit nënkupton alokimin optimal të burimeve brenda shtetit apo shoqërisë. Funksioni i shpërndarjes nënkupton rishpërndarjen e të ardhurës midis individëve dhe familjeve si dhe rishpërndarjen ndërsektoriale dhe ndërrijonale. Funksioni i stabilitetit nënkupton ndërhyrjen e shtetit me masat e politikës ekonomike, në rastet kur ekonomia ndodhet në disekuilibër. Financat publike në Kosovë karakterizohen me një pjesëmarrje relativisht të ulët të të ardhurave në buxhet me 27% të prodhimit të brendshëm bruto dhe nivele ende më të ulëta të borxhit publik (12%), në krahasim me vendet e tjera në rajon dhe Europë. Financat publike në Kosovë dhe menaxhimi i tyre rregullohet me ligj përkatës, i cili siguron standarde ndërkombëtare, me rol të theksuar të thesarit dhe centralizimit të funksioneve kyçe. Gjithashtu ligji aktual nuk lejon formimin e fondeve të posaçme në buxhetin e Kosovës, e që shpeshherë paraqitet si një kufizim për aktivitete specifike. (Drita Kongjeli)

FISET. Fisi si formacion i lashtë shoqëror, fillimisht si grup egzogam dhe parcial, historikisht i krijuar pas hordës, klanit dhe gjinisë veçohet me faktin e sesilitetit, meqë lidhet me territorin. Strukturimi i brendshëm i tij është gati uniform në kohë dhe hapësirë: familjet, barkthet, barqet dhe vëllazëritë që funksionojnë në një hierarki të rregulluar me norma të së drejtës zakonore e përbëjnë fisin. Te shumica e tyre dominon bindja e prejardhjes dhe lidhjes së gjakut të përbashkët qoftë reale, qoftë fiktive, por si e tillë shërben si faktor homogjenizues që e rrit solidaritetin dhe i ndihmon funksionit të mbrojtjes dhe të sigurisë. Ndonëse mbeturinat e organizimit

fisnor në ambiente ku ka qenë i vendosur sistemi i timarit, siç është Kosova, krahasuar me ambientin e Alpeve Shqiptare, janë të reduktuara edhe për shkak të shkapërderdhjes së kompaktësisë territoriale të fisit, lidhjet fisnore - qoftë nëpërmjet mbiemrave të njëjtë, apo mbamendjes mbi prejardhjen dhe lidhjen e gjakut të përbashkët janë ruajtur në formë të mirë. Konfuzionet lidhur me numrin e saktë, me kufizimin e përpiktë territorial, po edhe me hierarkinë kanunore kurrë nuk janë zbardhur. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të dyndjeve, copëtimeve administrative - sidomos me imponimin e institucionit të bajrakut nga ana e pushtuesve dhe procesit të konvertimit, që sidomos në Kosovë e ka përfshirë shumicën absolute të popullsisë. Popullsia e Alpeve Shqiptare që jetonte kryesisht nga blegtoria - si gjysmënomadë dhe nomadë, e vendosur nëpër “katune” (tëbanishta), formoi qendra banimi me dendësi më të madhe, të cilat pas një kohe e formojnë fisin. Krahas shumë faktorëve relevantë në procesin e formimit të fisit, padyshim se rëndësi ka edhe fenomeni i mbështetjes në fise, si dhe proceset e migrimeve. Prosesi i mbështetjes në fise merr një intensitet të shtuar në shek. XV dhe zgjat deri në formësimin definitiv të tij. Migrimet patën një intensitet më të madh gjatë kohës së depërtimit të ushtrisë osmane në këto vise, gjë që nxiti edhe kalimin nga një fis në tjetrin, nga vise të tjera në fiset dinarike dhe anasjelltas. Ky proces i migrimeve dhe i kalimit nga njëri fis në tjetrin nuk ka qenë i shkurtër, por ka qenë i gjatë dhe i mundimshëm. Fiset e zonës dinarike i karakterizojnë tërheqja në male, izolimi, homogjenizimi i brendshëm, ndjenja e përkatësisë së gjakut të përbashkët, solidariteti në mort, në konflikte, në gjakmarrje dhe në gazmende – si dhe sjelljet kryesisht destruktive ndaj fqinjëve. Lidhjet e forta me truallin marrin përmasa mitike dhe përcillen me mbyllje dhe rezistencë ndaj depërtimit të popullsisë së huaj, rrethana që në vazhdimësi gjenerojnë konflikte të jashtme dhe të brendshme. (Anton K. Berishaj)

FISET. Në kuptimin popullor tregonte prejardhjen e përbashkët të disa njerëzve nga i pari i fisit, pavarësisht nga largësia e brezave, vendndodhjes, përkatësisë fetare, etnike etj. Fisi karakterizohet nga lidhje të forta shoqërore dhe shpirtërore në mes të anëtareve, si: ndihma

e ndërsjellë, nderi i përbashkët dhe ndalesa e martesës me njeri-tjetrin. Burim kryesor që dëshmon qenien e një fisi, zanafillën dhe shtrirjen e tij është kujtesa popullore. Fiset e vjetra, sipas trunjeve gjenealogjike, kanë pasur mbi dhjetë breza: katërmbëdhjetë Shkreli e Krasniqja, pesëmbëdhjetë Kastrati, shtatëmbëdhjetë Bytyçi, tetëmbëdhjetë Kelmendi e Hoti. Fisi i madh kishte strukturë të zhvilluar, ndahej në vëllazëri dhe secila prej tyre degëzohej në barqe. Megjithatë, nuk gjendet asnjë gjurmë e organizimit fisnor. Bajraku, si lidhje bashkësish vetëm në Shalë, Bytyç, Shipshan e Shkrel, përputhej me fisin. Fisi i Hotit, i Thaçit dhe i Krasniqes ndaheshin në dy bajrakë, i Kelmendit në katër. Me regjistrimin traditës popullore lidhur me prejardhjen e fiseve dhe me ecurinë e tyre janë marrë J.G.Han, J.L. Hekard, E. Durham, F. Nopça, K. Jireçek, M. Shuflaj, G. Valentini, Gj. Karma, Rr. Zojzi, M. Krasniqi, S. Pulaha etj. Fisi i vogël, që më saktë quhej vllazni, ishte karakteristik për pjesën kryesore të trevës së organizimit të vjetër shoqëror dhe përfshinte nga dhjetë, deri në njëzet ose tridhjetë shtëpi. Emrat e fiseve vinin kryesisht nga të parët e tyre. Të dhënat e para për disa fise të mëdha, që sot nuk ekzistojnë, i përkasin fillimit të shek. XIV (për fiset e trevës ndërmjet lumenjve Mat, Erzen, Shkumbin e Devoll më 1308); për fiset Malaks, Buji e Mazarek në Thesali më 1333; për Manasejt më 1465; në fillim të shek. XIV për Tuzët e Bythëdosët në Malësi të Madhe. Në Kosovë, edhe sot e kësaj dite, pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare e dinë fisin, të cilit i përkasin. Edhe aktualisht, sidomos në zonat rurale dhe në shumicën e familjeve tradicionale, në një formë apo tjetër, respektohet origjina fisnore. Veçmas nuk pëlqehen ose edhe ndalohen martesat mes pjesëtarëve të të njëjtit fis. Gjithmonë flitet për dymbëdhjetë fiset shqiptare, por ka shumë dilema se cilat janë fiset kryesore dhe cilat janë nënfiset, vllaznitë (apo barqet). Megjithatë, në fiset kryesore, janë: Kuçi, Kelmendi, Kastrati, Hoti, Shala, Krasniqja, Gashi, Bytyçi, Thaçi, Berisha. (Bashkim Lajçi)


FISHER Joshka (Joseph Martin Fischer) (1948-). Politikan, diplomat gjerman. Lindi në Gerabronn të Baden-Vyrtembergut. Nga viti 1967 u angazhua në lëvizjen studentore dhe në opozitën jashtë-parlamentare. Deri në



JOSHKA FISHER

vitin 1975 ishte anëtar i grupit majtist radikal dhe militant i “Luftës Revolucionare”. Në vitin 1981, së bashku me Daniel Cohn-Bendit dhe të tjerët themeloi Partinë e Gjelbër. Në zgjedhjet e përgjithshme të 1983 u zgjodh deputet në Bundestag. Në periudhën 1998-2005 ishte ministër Federal për Punë të Jashtme dhe zëvendëskancelar i Gjermanisë në koalicionin kuq-gjelbër të Gerhard Shrederit (Shröder). Në këtë periudhë Gjermania mori vendim për t’iu bashkuar NATO-s në operacionet luftarake kundër Serbisë dhe për dërgimin e trupave ushtarake në Kosovë, për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore. J. Fisher pati rol të rëndësishëm në këtë vendim të qeverisë gjermane. Duke qenë se Gjermania mbante presidencën e radhës të Bashkimit European, J. Fisher doli me iniciativën për arritjen e kompromisit midis NATO-s dhe Serbisë, që u bë i njohur si “Plani Fisher”. Qëllimi i planit ishte që, në bashkëveprim me Rusinë, të hartohej një rezolutë në Këshillin e Sigurimit, e cila do t’u jepte fund të sulmeve ajrore të NATO-s. Pas luftime, Fisher botoi librin “Vitet kuq-gjelbër - Politika e jashtme gjermane - nga Kosova e deri më 11 shtator” (2007), në të cilën sjell fakte të rëndësishme edhe për historinë bashkëkohore të Kosovës. Në vitin 2004 Presidenti i Kosovës e dekoroi me “Medaljen e Artë e Lirisë”, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë për lirinë së Kosovës. (Sylë Ukshini)

FISHTA Gjergj (1871-1940). Poet, klerik i lartë, estet, politikan, polemist, dramaturg. Lindi në Fishtë të Zadrimës. U njoh dhe u pranua që në të gjallë të tij si poet kombëtar me



GJERGJ FISHTA

poemën epike “Lahuta e Malcís”. Ndikimi dhe kontributi që i madh edhe përtej letërsisë dhe, përveçse si shkrimtar, Fishta që i njohur edhe si klerik dhe politikan, si publicist dhe themelues institucionesh media-tike kulturore e arsimore. Shkollimin fillor e nisi në Seminarin Françeskan të Shkodrës dhe e vazhdoi në

seminarin e Troshanit. Studimet e larta për filozofi e teologji i kreu në Bosnjë, në kuvendin e Sutjeskës dhe të Livnos. Këtu bie në kontakt me veprat e poetëve sllavë, si Grga Martiq, Petar Petroviq Njegosh, dhe sidomos të autorit të tij të preferuar Ivan Mazhuraniq, ndikimi i të cilëve duket të ketë qenë i madh në këtë fazë, krahas autorëve të antikitetit grek e latin. U shugurua prift në vitin 1894, si klerik i Urdhrit Françeskan dhe fill pas kësaj i përkushtohet veprimtarisë intensive klerikale, kulturore e politike. Ishte një nga aktivistët e shoqërisë kulturore “Bashkimi” dhe përfaqësues i saj në Kongresin e Manastirit (1908), ku edhe u zgjodh bashkëkryetar i Komisionit të alfabetit të gjuhës shqipe. Në vitin 1913 themeloi revistën “Hylli i Dritës” dhe ishte kryeredaktori i parë i saj. Në vitin 1916 themeloi “Komisinë Letrare” bashkë me Luigj Gurakuqin dhe po atë vit ishte bashkëthemelues dhe drejtor për pjesën shqipe të gazetës “Posta e Shqypnis”. Ishte sekretar i përgjithshëm i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919). Ndërkohë viti 1921 e gjen deputet në parlamentin shqiptar dhe nënkryetar të këtij parlamenti. Në vitin 1921 themeloi gjimnazin françeskan “Illyricum” në Shkodër. Në vitet 1935-1938 u zgjodh provincial i Urdhrit françeskan dhe një vit më pas u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Italisë. Vdiq më 1940 dhe u varros me nderime të mëdha nga qyteti i Shkodrës. Pas vendosjes së regjimit komunist, vepra e tij shpallet reaksionare dhe i ndalohet qarkullimi. Në vitin 1967 varri i Fishtës u dhunua nga regjimi komunist dhe eshtrat e tij u hodhën në lumin Drin. Vepra e tij vazhdoi të komunikonte me lexuesit në Kosovë dhe në diasporë. Për herë të parë u botua vepra e tij e plotë në Prishtinë në vitet 1996-1997.

Përveç si poet epik përmes “Lahutës së Malcís”, Fishta krijon me sukses edhe në gjinitë lirike dhe dramatike. Prozën e ushtroi vetëm përmes publicistikës. Ka botuar këto vepra: “Lahuta e Malcís” (1905-1937), “Vierrsha të përshpirtshme të kthym në shqyp”, (1906), “Anxat e Parnasit” (1907), “Pika Voëset” (1909), “Sh. Françesku i Asizit”, Melodram (1912), “Mrizi i Zanave” (1913), “Gomari i Babatasit”, Poem dramatik (1923), “Juda Makabe” (1923), “Vallja e Parrizit” (1925), “Sh’Luigji Gonzaga”. Melodram (1927), “Shna Ndou i Padues” (1927), “Odisea”, “Ifigenia n’Aullí” (1931), “Jerina ase

Mbretnesha e luleve”. Poem dramatik (1941), “Hajria” (1942). Famën si poet kombëtar apo si “Homeri shqiptar” Fishta e fitoi përmes poemës epike “Lahuta e Malcís”. Blenin e parë të saj e botoi në vitin 1905 në Zarë të Kroacisë me titullin “Lahuta e Maltsiis - Kangë populllore-I, Marash Utsi”. Vepra e plotë me 30 këngët e saj u shfaq në vitin 1937, pra poetit iu deshën plot 32 vjet për ta përfunduar kryeveprën e tij, gjë që tregon se vetë poeti e vlerësonte këtë vepër mbi të gjitha veprat e tij. Poema ka strukturën e poemave epike si “Iliada”, “Eneida”, apo “Këngët e Rolanit”. Si narracion i madh kombëtar “Lahuta e Malcís” i korrespondon një faze gjysmëmilitare dhe gjysmëhistorike të zhvillimit kombëtar, prandaj Fishta e ka bërë qëllimshëm si zgjedhjen gjinore ashtu edhe formën e vargut të “Lahutës”. Prozodia e poemës i përgjigjet një faze të qytetërimit shqiptar të kapërcimit nga komunikimi oral te komunikimi shkrimor, fazë që, megjithë punën e paraardhësve të tij, kultura shqipe nuk e kishte tejkaluar ende në kohën kur shkruante Fishta. Si lirik, ndërkaq, Fishta u realizua përmes poezive të përmbledhura në botimet “Mrizi i Zanave” dhe “Vallja e Parrizit”. Vëllimi i parë është më tepër në vazhden e lirikës dhe emocionit patriotik të Rilindjes; vëllimi i dytë është në vazhden e literaturës metafizike religjioze. Mbizotëruese edhe këtu është poezia e angazhuar herë në funksion të etnisë, herë në funksion të besimit. Por në poemën “Nji lule vjeshtet”, Fishta shfaqet si lirik i pastër i intimes, i dhimbjes njerëzore, i mallit për humbjen e njeriut të dashur, si metafizik i jetës dhe vdekjes, i dashurisë ose i erotit pikërisht në kuptimin platonian të termit. Kjo poemë është ndër poezitë më të mira lirike jo vetëm të Fishtës, por edhe të krejt lirikës shqipe. (Mark Marku)

FJALORTHI I ARNOLD FON HARFIT.

Fjalorth nga shënimet e shtegtarit fisnik gjerman, shkrimtarit Arnold von Harff (rreth 1471-1505), i cili më 1496 kishte ndërmarrë një pelegrinazh në vendet e shenjta. Gjatë udhëtimit nga Italia nëpër Adriatik drejt Greqisë kishte ndaluar në Ulqin, Durrës e Sazan. Në Durrës ishte në pranverë të vitit 1497. Shënimet e tij u botuan më 1860 nga E. von Grote, në Këln, ndërsa Mario Rok i kishte rimarrë vetëm ato që kanë të bëjnë me shqipen në parathënien për ribotimin anastatik të Fjalorit të Frang Bardhit më 1932. Fjalorthi ka vlerë të kufizuar në suaza

të dokumentimit të shqipes. Shënime të tilla janë nga zonat gjuhësore gege. Në një material kaq të kufizuar dëshmohet një element me rëndësi: përdorimi i futurit me *do* në gegnishten: *do ta ble*. (Rexhep Ismajli)

FJALORTHË I PJETËR MAZRREKUT (Pietro Masarecco). Pjetër Mazrreku, argjipeshkëv i Tivarit (vdiq më 1635), në “Fjalim i shkurtë për kombin shqiptar dhe në mënyrë të veçantë për banorët e maleve të Dukagjinit” (Breve discorso sopra la natione Albanese et imparticular delli habitanti dei monti di Ducagini), për Kongregacionin e Shenjtë të Propagandës së Fesë, përfshirë në Scritturi riferite nelle congregazioni generali, vol. 263, Servia, Albania, Dalmatia, Illiricum ab ano 1630 ad 1639 inclusive, fol. 253-257, më 14 shkurt 1633, shënonte se shqiptarët “kanë gjuhë të ndryshme nga gjuhët e tjera me shumë fjalë italiane e greke”. Aty jepte një fjalorth të kufizuar si fjalë italiane. (Rexhep Ismajli)

FJALËT E URTA. Krijime të shkurtra gojore, të ngjeshura me përmbajtje figurative dhe didaktike, që shprehin gjykim të dalë nga një përvojë e përgjithësuar shoqërore dhe historike e njeriut, rëndom në një fjali ose periudhë të shkurtër, në formën e një formule koncize. Quhen edhe proverba, fjalë të mëdha, e në disa vise të Kosovës edhe fjalë me mend, “fjalë t’ holla, fjalë të burrave, fjalë të odave”. Paremiologjia është degë e folkloristikës bashkëkohore, e cila merret me studimin e proverbave, me shënimin, mbledhjen dhe botimin e tyre. Me kohë ato janë pasuruar, prandaj merren si një enciklopedi e filozofisë popullore, sepse e kanë formën e shprehjes logjike dhe të këshillës, si p.sh.: “Mos hin kah s’dilet”; “Cungat e mdhaj ruji për Shingjergj”; “Kryet gjog e mët zog”. Tematika e fjalëve të urta është e llojllojshme, si: atdheu, morali, temperamenti, puna dhe mjeshtëritë, familja, marrëdhëniet shoqërore etj. Karakteri përgjithësues, mënyra figurative e herë-herë e tërthortë e shprehjes së fjalëve të urta bëjnë që ato të përdoren edhe me më shumë kuptime, edhe në ditët tona, duke u përdorur në funksion të ri. (Leontina Musa)

FLAMURI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Është flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me rastin e shpalljes së pavarësisë. Flamuri është rezultat i



FLAMURI I KOSOVËS

një gare ndërkombëtare për dizajnimin e tij, e organizuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa u miratua nga Kuvendi i Kosovës menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Rezultat i kësaj gare ishin njëmijë punime që përmbanin variante e forma të ndryshme të propozimeve të flamurit të shtetit të Kosovës. Versioni që u përzgjedh është produkt i punimit të dizajnuar nga Muhamer Ibrahim, i cili u adaptua nga një komision i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Flamuri i Kosovës ka gjashtë yje të bardhë në një hark sipër një harte të Kosovës me ngjyrë ari, të vendosur në një sfond të kaltër. Yjet simbolizojnë gjashtë grupimet kryesore etnike të Kosovës: shqiptarët, serbët, turqit, goranët, romët (shpesh të grupuar me ashkalinjtë e egjiptianët) dhe boshnjakët. Përpara shpalljes së Pavarësisë, kur Kosova ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, ishte në përdorim flamuri i OKB-së për qëllime zyrtare, ndërsa popullsitë etnike kanë përdorur flamujt e tyre kombëtarë, ngjashëm me praktikën në periudhën e Jugosllavisë socialiste. Flamuri i Republikës së Kosovës është simbol shtetëror i vendit. Ngjyrat dhe forma e flamurit të Kosovës nuk janë përcaktuar ende me norma ligjore. Përdorimi i flamurit të Kosovës është rregulluar me Ligjin mbi përdorimin e simboleve të shtetit të Kosovës të datës 20 shkurt 2008. (Haki Kasumi)

FLAMURI KOMBËTAR SHQIPTAR. Simboli më i rëndësishëm i kombit dhe i shtetit shqiptar, simbol i identitetit kombëtar, i përbashkimit, që mishëron idealin e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare. Konsiderohet ndër flamujt më të vjetër që edhe sot është në përdorim. Burimet historike e lidhin zanafillën



FLAMURI KOMBËTAR SHQIPTAR

e tij me kohën e Skënderbeut, ndërsa simbolin kryesor të flamurit, shqiponjën dykrenore, tradita gojore dhe etnologjia e lidhin me një periudhë më të lashtë, me kultet dhe besimet popullore. Gjatë periudhës mesjetare, në kuadër të një tradite të përgjithshme europiane, prijësit arbërorë kishin flamujt dhe stemat e tyre familjare, në të cilat simboli më i përhapur ishte shqiponja dykrenore. U dëshmuar se Skënderbeu kishte në përdorim një flamur të kuq me shqiponjë të zezë dhe se ky flamur për një periudhë më të gjatë u takonte prijësve të Kastriotëve. Në luftërat dhe betejat e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane flamuri i Kastriotëve u përdor gjerësisht, duke u kthyer në simbol përbashkimi të prijësve arbërorë dhe njëkohësisht duke u bërë dëshmi e zgjerimit dhe konsolidimit të shtetit të tyre. Pas kësaj periudhe, gjatë sundimit osman, flamuri i Skënderbeut ishte i ndaluar dhe nuk u përdor për një kohë të gjatë, por ai u ruajt në kujtesën popullore, në dëshmitë e kohës dhe tek arbëreshët e mërguar në Itali. U rikthye sërish në kohën e Rilindjes Kombëtare dhe, krahas me konsolidimin e identitetit shqiptar, mori të gjitha tiparet e simbolit kombëtar. U popullarizua dhe filloi të përdorej gjerësisht në kolonitë shqiptare, për t'u rikthyer në atdheun e tij bashkë me frymën e lirisë dhe të përbashkimit. Shumë shpejt Flamuri Kombëtar u gjend në ballë të çetave kryengritëse, duke u bërë inspirim për sakrificë dhe heroizëm të shumë luftëtarëve për pavarësi kombëtare dhe shtetërore. U përdor gjerësisht në kryengritjet e viteve 1908-1912 dhe u kthye në simbol të themelimit të shtetit shqiptar, kur u ngrit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Pamja e flamurit

të ngritur në Vlorë u mbështet në ekzemplarët e sjellë nga kolonitë shqiptare dhe shërbeu si model për dizajnimin e të gjitha varianteve të mëvonshme, të cilat në vazhdimësi ruajtën elementet themelore heraldike: fushën e kuqe me shqiponjën e zezë dykrenore në mes.

Në Kosovë Flamuri Kombëtar Shqiptar ka historinë e tij të përdorimit. Pas kryengritjeve të përgjithshme të fillimit të shek. XX, me pushtimin serb të Kosovës, Flamuri Kombëtar Shqiptar u nxor nga përdorimi. Ai u ndalua në Kosovë dhe kujtesa për të filloi të zbehej. U rikthye sërish më 1941 pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, me përfshirjen e Kosovës në Shqipërinë Etnike dhe me bashkimin e hapësirave shqiptare në kuadër të "Tokave të lirueme". Pavarësisht se në këtë kohë iu shtuan simbolet fashiste, flamuri kombëtar shqiptar në Kosovë njohu për herë të parë përdorim zyrtar dhe popullor. Pas Luftës së Dytë Botërore, me përfshirjen e Kosovës në Serbinë dhe Jugosllavinë komuniste, përdorimi i Flamurit Kombëtar Shqiptar në Kosovë kaloi nëpër faza të ndryshme: ishte plotësisht i ndaluar, pastaj u përdor gjerësisht në kohën e emancipimit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, u zyrtarizua përdorimi i tij në kohën e autonomisë së Kosovës, iu ndryshua pamja dhe, së fundi, u ndalua plotësisht. Por pavarësisht nga luhajat e këtilla në përdorimin zyrtar, në përdorimin popullor ai u kthye në simbol të luftës së Kosovës për çlirim dhe bashkim kombëtar, u bë pjesë e identitetit kombëtar dhe mori tiparet e idhullit të adhurar gjerësisht. Për 50 vjet me radhë pjesëtarët e lëvizjes ilegale në Kosovë u betuan para tij, por edhe u burgosën dhe u persekutuan për idealet që mishëronte ai. Në vitet '90 të shek. XX, gjatë luftës për çlirimin e Kosovës, Flamuri Kombëtar Shqiptar ishte simboli me të cilin u identifikuan luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Përdorimi i tij i lirë në Kosovën e çliruar u kthye në simbol të identitetit dhe të aspiratës së popullit shqiptar të Kosovës për liri dhe mëvetësi. Pas shpalljes së Pavarësisë (2008), Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi flamurin shtetëror të Kosovës, por Flamuri Kombëtar Shqiptar, ndonëse i papërfshirë në Kushtetutën e Kosovës, vazhdoi të ketë përdorim krejtësisht të lirë dhe shumë të përhapur në Kosovë. (Mehmet Kraja)

FLORA. Në herbariumin e florës së Kosovës ende nuk është kryer plotësisht inventarizimi i florës vaskulare të Kosovës, për t'u ditur saktësisht numri i familjeve, gjinive, llojeve, nënlojeve e varieteteve bimore të përhapura në të. Kjo do të bëhet e mundur me vazhdimin e punës në grumbullimin e tërë materialit floristik në herbariumin kombëtar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, ku edhe më herët janë grumbulluar dhe sistemuar një numër taksonesh me shënime përkatëse. Rezultatet e kërkimeve të florës lokale, në pjesët e ndryshme të Kosovës, dëshmojnë për një florë mjaft të pasur të kësaj hapësire: në florën e livadheve ultësinore janë konstatuar rreth 300 taksonë, në masivin e Gërmisë 610, në Oshlak 717, në territorin e gjerë të Mirushës 590, kurse në Alpet Shqiptare 1,600 taksonë. Bazuar në këto të dhëna, mund të supozohet se në Kosovë janë të pranishme rreth 2,500-3,000 taksonë të florës vaskulare, që në raport me sipërfaqen e saj bëhet fjalë për një territor ndër më të pasurit në këtë pjesë të Europës. Në këtë pasuri floristike kanë ndikuar një varg faktorësh, siç janë: pozita fitogjeografike, kushtet klimatike, relievi i thyer, përbërja gjeologjike dhe pedologjike, e kaluara historike, ekzistimi i qendrave të endemizmit ballkanik. Florën e Kosovës e karakterizon një diversitet i madh, i shprehur në forma të ndryshme si ai taksonomik i pasqyruar përmes numrit të madh të kategorive të ndryshme: forma, varieteti, nënloji, lloji, gjinia, familja; diversiteti ekologjik i shprehur në forma të ndryshme jetësore, si aerofite, gjeofite, hamaekriptofite, hamefite, fanerofite; mënyrës së jetesës si gjysmëparazite (*Loranthus*, *Viscum*) dhe parazitë (*Cuscuta*, *Orobancha*). Diversitetin e florës vaskulare të Kosovës e karakterizon shumëllojshmëria e elementeve floristike tejet të ndryshme, si ai euro-aziatik, ballkanik, atlantik, ilirik, iliro-ballkanik, mezik, mediteran, submediteran, arko-alpik. Është i rëndësishëm depërtimi i elementit floristik nga baseni mesdhetar dhe submesdhetar, sidomos në trevën e Dukagjinit, nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë e po ashtu edhe grykës së Kaçanikut dhe luginës së lumit Lepenc, që kanë shërbyer si rrugë të përhapjes së elementit floristik submesdhetar deri në rrëzat e Sharrit. Florën e Kosovës e bën interesante edhe prania e një numri të madh të taksoneve endemike, subendemike dhe endemorelikte,

që kanë vlerë në fushën e floristikës. Në florën spontane të Kosovës janë të pranishme edhe shumë lloje të bimëve mjekësore, aromatike, foragjere, mjaltëdhënëse, ngjyruese, regjëse dhe zbukuruese, që kanë përdorim të gjerë në jetën dhe ekonominë e njeriut. (Feriz Krasniqi)

FOLKLORI. Është tërësia e traditës artistike të një populli, duke përfshirë besimin, mitet, besëtytnitë, mënyrën e jetesës, të punës, të veshjes e të ushqimit, këngët, muzikën, vallëzimin, artizanalet, pra mbarë kulturën popullore. Në kuptimin e gjerë, folklori barazohet me antropologjinë sociale dhe kulturore. Në një kuptim më të ngushtë folklori përfaqëson krijimtarinë popullore poetike, muzikore dhe koreografike: poezinë, këngën dhe vallet e një populli, prandaj edhe flitet për folklor letrar, folklor muzikor dhe folklor koreografik.

Folklori i Kosovës, si pjesë e folklorit shqiptar, është i pasur me lloje të shumta të prozës dhe të poezisë popullore. Brenda temave dhe motiveve të krijimeve folklorike, si në prozë (përralla, kallëzime, anekdota, fibula etj.), ashtu edhe në poezi (këngët epike, të kreshnikëve, balada, këngë historike, si edhe në llojet e shumta të lirikës popullore) ekzistojnë edhe motive të ngjashme ose të përbashkëta të popujve të ndryshëm. Folklorin shqiptar nisi ta mbledhë i pari Frang Bardhi dhe më pas romantikët, ndër të cilët shquhet Thimi Mitko me "Bëletën shqiptare". Në periudhën midis dy luftërave botërore është botuar seria folklorike në disa vëllime "Visaret e kombit" (1937-1944), ku është përfshirë edhe eposi i kreshnikëve dhe përrallat popullore. Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore folklori shqiptar është botuar në disa vëllime, në poezi e në prozë, nga Instituti i Kulturës Popullore i Tiranës dhe nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, i cili ka botuar deri tash 28 vëllime me materiale të ndryshme folklorike në poezi dhe në prozë. (Sadri Fetiu)

FOLKLORISTIKA. Është shkenca që merret me mbledhjen, botimin dhe studimin e folklorit. Folkloristi i parë shqiptar konsiderohet Frang Bardhi, i cili brenda "Fjalorit" të tij kishte përfshirë edhe 113 fjalë të urta popullore. Përmbledhja e parë e krijimeve poetike folklorike është "Dorëshkrimi i Kieutit" (1737) nga Nikollë Filja. Me mbledhjen, sistemimin dhe botimin e folklorit janë marrë pothuajse

të gjithë romantikët arbëreshë: Gavril Dara (Plaku), Vinçenco Dorësa, Dhimitër Kamarda, De Rada, Zef Skiroi etj. Me folklorin shqiptar janë marrë edhe studiuesit e huaj, midis të cilëve shquhen Hani, Dozoni, Dora D'Istria, Lamberci, Pedersen etj. Veprat folklorike të periudhës së romantizmit janë botuar nga Zef Jubani, Spiro Dine, Thimi Mitko etj. Me rëndësi të veçantë për folkloristikën shqiptare janë vëllimet “Visaret e kombit” (1937-1944), përmbledhjet “Zana popullore” e K. Taipit (1933), pastaj “Përrallat” e Donat Kurtit (1942), si edhe përmbledhjet e Vinçenc Prenushit dhe të folkloristëve të tjerë. Rol të veçantë për folkloristikën shqiptare kanë luajtur edhe revistat “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe “Albania”. Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë u botua vepra e parë folklorike “Kangë popullore të Kosovës dhe Metohisë” (1951), e përgatitur nga Zekeria Rexha, të cilën e ndaloi censura e asaj kohe dhe i dogji 3,000 ekzemplarët e saj. Më vonë, në vitet 1952-53 janë botuar, me kritere të veçanta përzgjedhëse, tri vëllime me poezi popullore: epikë legjendare, epikë historike dhe lirikë popullore, të përgatitura nga Vojislav Dançetoviq, Anton Çetta dhe Kadri Halimi. Pas themelimit të Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë dhe Institutit Albanologjik në Prishtinë, folkloristika shqiptare vihet mbi baza më të sigurt shkencore. Është bërë një punë e madhe për mbledhjen e materialit në terren, pothuajse në të gjitha viset shqiptare si nga punonjësit e rregullt të institucioneve shkencore, ashtu edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Janë mbledhur dhe arkivuar (pjesërisht edhe digitalizuar) njësi të shumta të të gjitha llojeve të folklorit, ndërsa janë botuar vëllime të shumta me materiale folklorike dhe ka filluar periudha e studimit të mirëfilltë të folklorit shqiptar. Krahas botimit të tri vëllimeve “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar” (1961-62), janë botuar edhe studime të veçanta për folklorin në revistat shkencore “Kultura popullore” dhe “Çështje të folklorit shqiptar” (Tiranë) dhe “Gjurmime albanologjike”, seria folklor dhe etnologji, në Prishtinë (deri tash 45 numra). Njëkohësisht janë specializuar një numër studiuesish të folklorit dhe janë botuar edhe një varg studimesh monografike. (Sadri Fetiu)

FOLMET KALIMTARE (TË). Janë të folme që kapin zonën midis dy kryedialekteve të shqipes,

të cilat shtrihen në një brez toke përgjatë krahut të majtë të lumit Shkumbin, duke filluar nga Qafa e Thanës në lindje e deri në bregdet, aty ku edhe bëhet derdhja e Shkumbinit, në perëndim. Të folmet kalimtare gjallojnë: në Rajcë, në Bërzesh të, në Vërçë, në Shpat, në Sulovë, në Dumre, në Darsi, në Bregdetin e Poshtëm të Kavajës dhe në pjesën veriore të fushës së Lushnjës. Këto të folme nga të gjithë studiuesit trajtohen si një grup të folmesh që gërshetojnë tipare nga të toskërishtes dhe të gegërishtes. Sidomos karakteri kalimtar i tyre mbështetet në përzierjen e pesë tipareve kryesore, që dallojnë gegërishten nga toskërishtja, veçanërisht prania e hundorësisë dhe e rotacizmit (shpeshherë edhe në të njëjtat fjalë: *zā^ori*, *shullā^ori* etj.), kundërvëniet *vo/va*, kuantiteti i vokaleve dhe infinitivi gegë janë tipare që i karakterizojnë këto të folme si grup në vete. (Imri Badallaj)

FONDI “VENDLINDJA THËRRET”. Fond i ngritur nga Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) për të ndihmuar luftën çlirimtare në Kosovë. Fondi u themelua në Zvicër në vitin 1993 dhe ishte dedikuar ekskluzivisht për rezistencën e armatosur, për nevojat e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Mjetet e Fondit “Vendlindja thërret” ishin kontribute vullnetare të diasporës shqiptare në Europë dhe në SHBA, Kanada dhe Australi. Para themelimit të këtij fondi, mjetet materiale-teknike për përgatitjen e luftës mblidheshin ekskluzivisht nga anëtarët e LPK-së. Me krijimin të Fondit u hap mundësia që kontributin për luftën çlirimtare ta jepnin të gjithë ata që e shihnin luftën çlirimtare si rrugë të vetme për çlirimin e Kosovës. Deri në vitin 1996, për arsye të ndryshme, grumbullimi i mjeteve financiar në Fondin “Vendlindja thërret” ishte modest. Niveli i kontributeve filloi të rritej vetëm më 1996 dhe 1997, duke u shtuar më 1998 dhe 1999, kur rrjedha e ngjarjeve në Kosovë mori drejtimin e luftës së hapur me Serbinë. Me intensifikimin e aksioneve të UÇK-së, veçmas nga viti 1997, u shtuan ndjeshëm edhe kontributet e mërgimtarëve nga Kosova, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi. Ky shtim i mbështetjes financiare dhe materiale e teknike ndikoi edhe në përgatitjen më të mirë dhe në efikasitetin e aksioneve të UÇK-së. Mbledhja e fondeve për UÇK-në ishte e decentralizuar. Struktura organizative e Fondit “Vendlindja thërret” përbëhej nga Këshilli

Qendror i Fondit. Kryetar i këtij Këshilli ishte Jashar Salihu. Këshillat qendrore të Fondit ishin formuar në nivel të shteteve europiane, në SHBA, në Kanada dhe në Australi. Mbledhësit e autorizuar të fondeve ishin të angazhuar në mënyrë vullnetare. Puna e tyre ishte mirë e organizuar dhe e dokumentuar. Mjetet financiare të grumbulluara nga aktivistët e Fondit siguroheshin kryesisht prej kontributeve vullnetare të mërgimtarëve, të cilët i fitonin në mënyrë të ligjshme mjetet financiare. Me përfundimin e luftës, mjetet e mbetura financiare iu dorëzuan udhëheqësve të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. (Agush Buja, Sylë Ukshini)

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN). Agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, organizatë e pavarur ndërkombëtare, e cila ka statutin e vet, strukturën qeverisëse, financat dhe ka 188 vende anëtare. Angazhohet për të nxitur rritjen globale dhe stabilitetin ekonomik, u ofron këshilla për politikat ekonomike dhe financim anëtarëve në vështirësi, si dhe punon me vendet në zhvillim për t'i ndihmuar ato në arritjen e stabilitetit makroekonomik dhe reduktimin e varfërisë. FMN-ja promovon gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar monetar dhe stabilitetin e kursit të këmbimit, lehtëson rritjen e balancuar të tregtisë ndërkombëtare dhe ofron burime për të ndihmuar anëtarët për tejkalimin e vështirësive të bilancit të pagesave. Nëpërmjet mbikëqyrjes së saj ekonomike, FMN-ja monitoron shëndetin ekonomik të vendeve anëtare të saj, duke i njoftuar ato për rreziqet dhe duke u ofruar këshilla rreth politikave. Ajo gjithashtu jep kredi për vendet në vështirësi dhe ofron asistencë teknike dhe trajnim për të ndihmuar vendet që të përmirësojnë menaxhimin ekonomik. Që nga viti 1999 Kosova ka pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me FMN-në, i cili është bazuar kryesisht në ndihmën e FMN-së rreth zhvillimit të politikave makroekonomike, si dhe në asistencën teknike për zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve vendore. Në vitin 2009 Kosova është bërë anëtare e rregullt e FMN-së. Që nga anëtarësimi, Kosova e ka përmbjllur me suksese një marrëveshje programore me këtë institucion, ndërsa në vitin 2015 Kosova dhe FMN-ja kanë hyrë në një marrëveshje të re programore. (Arben Mustafa).

FONIQI Shaqir (1950-). Gazetar. Lindi në Llazicë të Klinës. Shkollimin e mesëm e kreu në Klinë, kurse Fakultetin Juridik, drejtimi i gazetarisë, e mbaroi në Prishtinë. Nga viti 1977 ishte gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), kurse nga viti 2000 gazetar dhe redaktor i kulturës në Radiotelevizionin e Kosovës. Pas mbylljes së dhunshme të RTP-së, punoi për një kohë në Televizionin Shqiptar, programi për Kosovë, ndërsa ishte edhe pjesë e ekipit që punoi në "Offener Chanal" (Kanali i hapur) të Berlinit, programi për komunitete. Ka botuar disa monografi publicistike-artistike për Aleksandër Moisiun, Nexhmije Pagarushën, Gjellosh Gjokajn, Bekim Fehmiun etj. Është autor i tekstit "Teori dhe praktikë gazetarie" (2000) dhe i librave me poezi: "Udhëtime" (2005), "Portat e diellit" (2007), "Diell në shuplakë" (2010) etj. (Veli Bytyçi)

FONIQI Tahir (1944-2015). Poet, bibliograf. Lindi në fshatin Llozicë të Malishevës. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në Kijevë, të mesmen në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi në arsim, mandej në Bibliotekën Popullore Universitare të Kosovës në Prishtinë. Shkroi për fëmijë e të rritur, poezi e prozë, libra nga fusha e bibliotekarisë dhe bibliografisë. Veprat letrare: "E shoh në dritë" (1973), "Mos e kërkoni në ëndrra" (1983), "Mbreti barbar" (1987), "Vdekja e Hanmit" (1989), "Emblema e vrerosur" (1995), "Dueti legjendar" (2000), "Jetë nëpër dhëmbë" (2009). Nga fusha e bibliotekarisë dhe bibliografisë botoi gjithashtu disa vepra: "Tema nga biblioteka" (2003), "Bibliografia e revistës 'Koha' 1978-1989" (2004), "Monografi për Bibliotekën ndërkombetare në Prizren" (2004), "Si u bëra i anatemuar" (2005), "Kërkime bibliografike" (2008), "Tipat e bibliotekave në Kosovë" (2008) etj. (Nazmi Rrahmani)

FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS (FSK). Është forcë e sigurisë kombëtare e Republikës së Kosovës, e themeluar më 21 janar 2009. Sipas nenit 126 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, FSK-ja do të shërbejë si forcë e sigurisë kombëtare për Republikën e Kosovës, por mund t'i dërgojë pjesëtarët e vet jashtë vendit, në pajtim me përgjegjësitë e veta ndërkombëtare. FSK-ja ka për detyrë t'i mbrojë qytetarët dhe komunitetet e Republikës së



NJË PARAKALIM I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS


Kosovës, bazuar në kompetencat që ia siguron ligji. Kryetari i Republikës së Kosovës është kryekomandant i FSK-së, e cila i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile, të zgjedhura në mënyrë demokratike. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) është ministri e integruar, me nëpunës civilë dhe të uniformuar brenda strukturës unike organizative, sipas shembullit të disa shteteve të NATO-s. MFSK-ja është përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit civil mbi FSK-në, duke përfshirë edhe menaxhimin dhe administrimin, si dhe ka kompetenca të zhvillojë politikat dhe aktivitetet e FSK-së brenda kornizës ligjore dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. FSK-ja është forcë e re e sigurisë, profesionale, shumetnike, e armatosur lehtë dhe e uniformuar. Misioni i FSK-së është që të kryejë operacione të reagimit të shpejtë, t'u ndihmojë autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. Detyra të tilla përfshijnë operacionet e kërkim-shpëtimit, mënjanimin e mjeteve shpërthyes, kontrollin dhe pastrimin e materieve të rrezikshme, si dhe detyra të tjera të ndihmës humanitare. (Ali Uka)

FORMACIONET LETRARE. Përbëhen nga korpuse veprash, të lidhuara për poetika e të dëshmuara në nivel teorik me tekste programatike ose si praktika letrare që nënkuptojnë vepra me veti letrare të përafërta, por që nënvizojnë në veçanti stilin. Formacionet janë fenomene letrare që shtrihen përtej një letërsie të caktuar dhe provohen si fenomene universale të letërsisë që kanë trajtën e modelit që përsëritet. Ndërsa, brenda letërsive të veçanta, formacionet, në tekstet historiko-

letrare, identifikohen me drejtimet dhe marrin emërtime të tipit klasicizëm, romantizëm, realizëm, simbolizëm, ekspresionizëm etj. Historia letrare e provon se formacionet letrare janë tipike për letërsitë e cilësuar të mëdha dhe se projektohen edhe te letërsitë e tjera përreth, si përsëritje në shkallë të ndryshme, varësisht nga afërsia kulturore e letërsisë që do t'i ngjajë formacionit letrar „origjinar”, ndërsa vetë kthehet në mësim letrar të tij. Në rrafshin teorik të konceptimit formacionet lidhen edhe me një bazë stilistike, e cila zgjerohet në poetikë që lidh stile, sensibilitete e tema. Kur formacioni letrar bëhet dominant, identifikohet me epokën letrare si emërtim e si përfaqësim, siç ndodh me modernizmin, i cili, vërtet, është një rrjet formacionesh. Në kuptimin e një praktike, formacioni identifikohet me një tip letërsie që ka një metodë, një numër pikëpamjesh dhe përfatesh letrare të përbashkëta ose të ngjashme. Kjo duket më hapur dhe e dëshmuar në nivel teorik në modernitet. Formacionet letrare shqipe e provojnë historinë atipike të shqipes që kthehet në histori të veçantë, pra tipike për të, me përftesa ngjashmërisht me formacionet e letërsive të tjera, por që këputen e rishfaqen, apo dalin e nuk zhvillohen, ashtu siç ndodh me një numër të rëndësishëm të fenomeneve letrare shqipe. Ndërsa shfaqja më autentike e tyre është në trajtë trashëgimie, si p.sh. poezia e Lasgush Poradecit që njih trashëgiminë e simbolizmit, apo ajo e Mjedjes të klasicizmit, parnasizmit e të simbolizmit përnjëherë, të kryqëzuara me frymëzime të trashëgimisë romantike. Çështja bëhet më e ndërliqshme me gjithë letërsinë moderne shqipe, e cila, më parë se formacione, zbulon vepra e autorë të veçantë. Në letërsinë e Kosovës shenjat e poetikave, të shoqëruara edhe me diskurs teorik, duken më hapur, nga vitet '70 të shekullit XX, kur autorët modernë të Prishtinës nisin aventurën e zbulimit e të njohjes së letërsisë europiane e perëndimore në përgjithësi, krahas zbulimit nga fillimi të letërsisë e të kulturës shqiptare. Aty përftesat e provat poetike universale kryqëzohen me sensibilitet e tema autentike në një përftim autentik të poetikave. Vetë letërsia shqipe i relativizon emërtimet e termat e fortë të fenomeneve historike të saj, prandaj sa herë që insistohet te skajimet e tek emërtimet e prera, përsëriten skemat e letërsive të tjera si skema të letërsisë shqipe. Pothuajse e gjithë letërsia shqipe e Kosovës është e re dhe kap gjysmën e dytë të

shekullit XX. Ajo njohu letërsinë sociale, me rrënjë në vitet '30, përftesa të realizmit social, të cilat shpejt i la pas dhe, me autorët e me veprat themelore u bë letërsi moderne, e karakterizuar me tema të vendit, të etnisë e me temat e thella personale, në përgjasime letrare meZ vepra moderne europiane. (Kujtim M. Shala)

FORMULA E PAGËZIMIT (1462). Dokumenti më i vjetër i shkruar shqip i datuar me saktësi. Kryepeshkvi i Durrësit, imzot Pal Engjëlli (1417-1470) më 8 nëntor 1462



kishte shkruar një Letër qarkore latinisht (Constitutiones), të cilën e kishte nisur nga Kisha e Shenjtes Trini në Mat. Kishte porositur meshtarët që ta këshillonin popullin që, në rast se kishte rrezik për ta sjellë foshnjën në kishë për ta pagëzuar, këtë gjë mund ta bënin në shtëpi duke përdorur formulën liturgjike të pagëzimit. Formula, të cilën Pal Engjëlli e rekomandonte, është e zakonshme në shërbimet fetare. Dokumenti origjinal ndodhet në dorëshkrim në Firencë, në Bibliotekën Laurentiane: Ashburnham 1167, fol. 3-4. E ka botuar Nikollae Jorga (1915), 194-197. Teksti është ky: *Vnte' paghesont premenit Atit et birit et spertit senit.* [Un të pagëzoni p'r emënit (t')Atit e t'birrit e t'shpertit shënjtë]. (Rexhep Ismajli)

FORTIFIKATA E DOBËRÇANIT (Dobruçan, Dobruzan). Lokalitet shumështrësor me mbetje muresh nga periudha e hershme bizantine (shek. IV-VI). Gërmadhat e kalasë shtrihen rreth 12 km në verilindje të Gjilanit, në pjesën veriperëndimore të fshatit po më këtë emër. Nga gjetjet e rastit dhe hulumtimet e pjesshme mund të provohet edhe shtresa që i përgjigjet substratit dardan. Edhe pse muret janë të rrënuara, nga mbetjet e tanishme, sidomos në pjesën

jugore, perëndimore dhe verilindore duket se bëhet fjalë për ndërtime me gurë të madhësive mesatare, me mbushje me gurë më të vegjël në pjesët e brendshme, ndërsa ballinat e mureve të gdhendur me kujdes dhe të përforcuara me llaç gëlqereje. Fortifikata ka formë ovale, që është kushtëzuar nga konfiguracioni i terrenit, ndërsa në pjesën më të madhe të kontureve ndërtuese ngjan me kalanë mesjetare Prilepci, në afërsi të Novobërdës. Kalaja është ngritur në kodrinën mbi fshat, pranë rrjedhës së ujërave termale të Banjës së Dobërçanit, në lartësi mbidetare prej 580-600 m dhe zë një hapësirë gjeostrategjike me interes për mbrojtjen e popullatës, që shtrihej në vendbanime përreth itinerarit sekondar, i cili lidhte Novobërdën me pjesët tjera të Dardanisë Lindore. Megjithëse mjaft e dëmtuar, fortifikata ka ruajtur përgun nga ana verilindore, ndërsa në vijën gjatësore jugperëndim-verilindje ka gjatësi 105 m, kurse në gjerësinë juglindje-veriperëndim është 50 m. Dimensionet e mureve në pjesët e padëmtuara arrijnë në 1.80-2 m.

Si lokalitet ishte banuar në vazhdimësi dhe në dokumentet e shkruara ndeshet me emrin Dobruçani (1437). Përmendet gjithashtu edhe në Defterin e Kazasë së Novobërdës (1498), ku paraqiten të regjistruar 59 kryefamiljarë dhe bashkina, si edhe në një defter tjetër kadastral osman (1566-1674). Në një hartë nga viti 1689 e ndeshim me emrin Dobruçan. (Faik Sahiti)

FORTIFIKATA E PRESHEVËS (shek. IV-VI). Gjendet në skajin perëndimor të qytetit të Preshevës. Qyteti-fortifikatë shquhet për vazhdimësinë e jetës, së paku nga shek. IV, për



FORTIFIKATA E PRESHEVËS E SHEKULLIT VI

t'u ngjitur në shekuj të mesjetës dhe më vonë, deri në vitin 1530, kur e përmend për herë të

fundit udhëpërshkruesi dhe diplomati austro-hungarez, Benedikt Kuripeshiq (Benedict Curipeschitz von Oberburg, rreth 1490-?). Sipas tij, qyteti-fortifikatë dallohej për nga bukuria dhe qëndrueshmëria. Fortifikata ka qenë shpesh në objektivin e sundesve nemanjidë, si dhe të pasuesve të tyre. Është përmendur disa herë edhe në kontekst me Novobërdën, me rastin e sulmeve osmane (1412, 1427). Fortifikata është ngritur në kodrinën shkëmbore në lartësi prej 740 m. Ajo shtrihet mbi shpatin e pjerrët me pamje nga qyteti i Preshevës, pranë së cilës kalon lumi Kurbalia dhe dy përroska më të vogla. Në pjesën perëndimore është e lidhur nëpërmjet një lugine të shkurtër me masivin malor të Karadakut, derisa pamja e hapur lindore ofron mundësi për të kontrolluar luginën e Preshevës, nëpër të cilin kalonin rrugë të rëndësishme. Pjesa kryesore e fortifikatës ka formë elipsoide me dimensione 60 x 35 m. Muret rrethuese janë të ndërtuar me gurë të madhësive të ndryshme, të formësuar mirë në fuga me llaç gëlqereje. Në pjesën juglindore fortifikata kishte një kullë vrojtuese në trajtë të rrumbullakët, me perimetër në pjesën e brendshme 2.40 m, ndërsa trashësia e mureve është 2 m. Nga ana verilindore, veriore e veriperëndimore fortifikata kishte mbrojtje natyrore. Në oborr të kalasë ka pasur një pus (sterë) me ujë, që ndodhej në anën perëndimore, nga ka qenë edhe hyrja kryesore. Fortifikata u ndërtua gjatë periudhës së hershme Bizantine (IV-VI). Siç duket nga pozicioni i saj, fortifikata ishte projektuar për mbrojtje të luginës, së bashku me fortifikimet e tjera të Rahovicës, të Bushtanit e më tutje të Kërshevicës. (Faik Sahiti)

FORTIFIKATA E SIÇEVËS. Shtrihet rreth 10 km në verilindje të Prishtinës. Fortifikata ngrihet në anën verilindore të shkollës së fshatit, në lartësi mbidetare 780 m. Fragmentet e mureve, tjegullat, shtyllat e zbuluara dhe kisha e vjetër dëshmojnë se kemi të bëjmë me një lokalitet të rëndësishëm arkeologjik. Në anën lindore të fortifikatës, në kodrën e quajtur Kuna, janë zbuluar themelet e një kishe të vjetër dhe varret përreth saj. Përballë fortifikatës, në distancë prej rreth 2 km, është Suka e Radashecit-Grashticës, e njohur nga popullata lokale edhe si Sulltan Tepe. Në lindje të Sukës është lokaliteti arkeologjik Arat e Rrafshit të fshatit Grashticë, ku janë zbuluar

varreza me urna të periudhës antike. Në mes të fortifikatës së Siçevës dhe në veriperëndim të Sukës së Radashecit ka themele të objekteve dhe dy kishave. Në anën jugore të fortifikatës së Siçevës, në distancë prej 3 km, shtrihet lokaliteti i njohur arkeologjik në fshatin Bërnice. Në anën veriore, në distancë prej rreth 2 km, ngriten dy sukat, lokaliteti arkeologjik, Rogat e Prishtinës dhe dy kishat e vjetra në fshatin Rimanishtë. Në anën veriore në distancë prej rreth 5 km shtrihet lokaliteti arkeologjik Nina Kola, kisha e vjetër dhe fortifikata në fshatin Sharban. Në anën jugperëndimore të kësaj fortifikate ka kaluar rruga e rëndësishme antike Nish-Lezhë, andaj kjo fortifikatë dhe lokalitetet e tjera përreth, që shtrihen në mes të Rrafshit të Kosovës dhe të Llapit, si dhe në afërsi të minierave, dëshmojnë për një qytetërim të shtresuar në vazhdimësi nga periudha dardane deri në periudhën bizantine dhe më tej. (Qazim Namani)

FORTIFIKATAT MESJETARE. Fortifikata që u ndërtuan në periudha të ndryshme, të mesjetës, për t'u mbrojtur nga dyndjet "barbare". Periudha e shek. IV- VI të e. s. ishte periudha më intensive e ndërtimit të fortifikatave. Dyndjet e gotëve, të hunëve dhe më pastaj të sllavëve, të avarëve dhe bullgarët krijuan rrethana, të cilat imponuan krijimin e një sistemi të ri fortifikues, të shoqëruar me ndërtime dhe rindërtime të fortifikatave të vjetra, në përputhje me kërkesat e reja të mbrojtjes.

Fortifikimet në trevat tona zënë fill me ndërtimet e tipit *castrum*, ndërsa kulmojnë në shek. VI me përfundimin e një rrjeti të dendur fortifikatash të kohës së Justinianit. Në librin "De aedificis" (Mbi ndërtimet), Prokopi përmend "madhëstinë e ndërtimeve të perandorit Justinian", i cili "kishte origjinë nga Dardania". Në trevat ilire, Justiniani ndërtoi dhe rindërtoi 167 fortifikata, ndërsa vetëm në Dardani rindërtoi 61 dhe ndërtoi 8. Nga vargu i fortifikimeve të ndërtuara gjatë periudhës së hershme bizantine, pa lënë anash dy qendrat e mëdha (Justiniana Secunda, te Ulpiana), Justiniana Prima (te Lebani)), veçojmë këto fortifikime: Besiana, Budriga, Binça, Cërmjani, Dresnik-Dollc, Durman Gegje, Gërncarë, Glllogovicë, Suhogërlle, Gjryshhec, Harilaç, Jabllanicë, Kasterc, Keqekollë, Klopotnik, Koliq, Korishë, Krilevë, Krindell, Kusarë,

Laberion dhe Labutza (Llap), Llapushnik, Marec, Miresh, Pejë, Prizren, Resula, Tërpezë, Trepçë, Tugjec, Veletin, Vërboc, Vraniq, Zatriç, Zhegër etj. Megjithatë, ky sistem fortifikues nuk pengoi për kohë të gjatë vërshimet avarosllave e bullgare.

Fortifikimet mesjetare janë të shumta dhe ndodhen zakonisht përgjatë luginave të lumenjve, ku kalonin rrugë të rëndësishme tregtare dhe ushtarake, si dhe në pika strategjike, nga të cilat kontrollohej një rajon më i gjerë. Fortifikatat ishin të lidhura në një sistem, që kishte për qëllim mbrojtjen e vendbanimeve, të zonave të pasura minerare, pranë luginave të rëndësishme lumore të dy traseve të rëndësishme rrugore: Nish-Vrajë-Preshevë-Shkup, dhe Nish-Ulpianë-Shkup, përkatësisht Ulpianë-Prizren-Lezhë, duke mos lënë anash arteriet e tjera rrugore që lidheshin me to. Në shek. XI, pas themelimit të Themës së Shkupit dhe gjatë shek. XII, rifilloi riparimi i kështjellave të vjetra dhe ndërtimi i kështjellave të reja bizantine. Kjo lidhej me fillimet e pushtimeve dhe të ngulitjeve sllave e bullgare në trevat e Dardanisë, që njëherësh kërcënonin seriozisht Bizantin. Rol më rëndësi në këtë kohë kanë luajtur fortifikatat e Dresnikut, Petriçit të Vogël e të Madh, të Prizrenit, të Veletinit, të Zveçanit etj. Gjatë shek. XIII-XIV ndërtohen një varg fortifikatash, të cilat përveç rëndësisë së tyre mbrojtëse, shquheshin edhe si qendra të njohura administrative, ekonomike e kulturore-fetare, si: Çajlija (Brezovicë), Hisari (Drini Bardhë), Janjeva, Kaçaniku, Novobërda, Pogragja, Prilepci, Prizrenci, Trepça, Vuçitërna etj. Ndërkaq, periudha e pushtimit osman karakterizohet me rrënimin e shumë fortifikatave dhe meremetimin e kështjellave të rëndësishme, kryesisht nëpër qendrat tregtare dhe pranë rrugëve të rëndësishme (Kaçaniku, Prizreni, Novobërda, Zveçani, Pogragja, Prilepci, Prizrenci etj). (Faik Sahiti)

FORTINO Italo Kostante (Costante) (1947-). Albanolog, profesor arbëresh. Lindi në Shën Benedit (San Benedetto Ullano), afër Kozencës. U diplomua në Universitetin e Romës dhe nisi punë si kërkues shkencor në katedrën e shqipes në Universitetin e Kalabrisë, ku mbajti edhe lëndët e kritikës së tekstit dhe të letërsisë gojore. Një kohë punoi në Qeverinë e Italisë dhe më pas profesor në Universitetin “L’Orientale” të Napolit, ku për disa vjet drejtoi katedrën e



ITALO FORTINO

gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Botoi artikuj shkencorë për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Më 1984 bëri botimin kritik të “Gjellës së Shën Mërisë virgjër” të Varibobës. Ka redaktuar dy vëllime me artikuj për albanologjinë, vëllimet e Varibobës, të Santorit, të Noçitit etj. dhe “Atlasin dialektologjik të shqipes” (2008). Drejtoi edhe revistën “Albanistica”. Disa vjet radhazi ishte pjesëmarrës i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. Si drejtues i departamentit në Napoli kishte marrëveshje bashkëpunimi me departamentin e gjuhës shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. (Lindita Rugova)

FRAKULLA Nezim (1685-1759). Përfaqësuesi më i rëndësishëm i alhamiados shqiptare, i cili tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve të letërsisë. Rrjedh nga familja fisnike Vlora, e cila i dha shumë njerëz të shquar jetës politike, ushtarake e kulturore në periudhën osmane. Lindi në fshatin Frakull. Mësimet e para i mori në mejtep. Në Berat kreu medresenë, në Stamboll ndoqi studimet e larta. Në vitin 1731 u kthye në Berat dhe filloi të shkruajë poezi në gjuhën shqipe me alfabet arab, duke vënë themelet e një rryme të re, me tematikë e motive të reja. Pas një kohe, u largua nga Berati dhe shkoi në Stamboll, ku më pas vdiq nga mortaja. La pas një divan me poezi shqip, i botuar më 2008 dhe dy divane turqisht e një persisht. Konsiderohet krijuesi i divanit të parë në letërsinë shqipe. Si me poezitë në gjuhët orientale, ashtu dhe me ato në gjuhën shqipe ndoqi principet e poetikës orientale, me formën, zhanrin, idealin e jetës, por edhe me idealin artistik. Krijimtaria poetike e tij shquhet për shkak të temës fetare mistike që trajtoi me mjeshtri, por edhe për temat e tjera shoqërore, didaktike, për cilësinë e krijimtarisë së tij dhe për tipologjinë e krijimtarisë fetare. Mes figurave letrare, N. Frakulla arrin t’i japë ngjyrimet e veçanta gjuhës dhe stilit, që do të jenë të pranishme edhe pas tij në poezinë shqipe në përgjithësi dhe në atë alhamiada në veçanti. (Abdullah Hamiti)

FRANÇESKANËT. Pjestarë të njerit ndër urdhërat më të rëndësishëm të Kishës Katolike, i themeluar në fillim të shek. XIII nga murgu Françesko i Asizit. Për nga zanafilla shoqërore françeskanët i takonin shtresave më të varfëra dhe bënin një jetë të thjeshtë dhe asketike. Më vonë françeskanët pësojnë disa ndryshime në doktrinën e tyre, duke themeluar edhe dy urdhëra. Në vitin 1212 u themelua “urdhri i dytë” i përbërë nga femrat të quajtur “Klarise” sipas murgeshës Klara e Asizit, kurse në vitin 1221 u themelua “urdhri i tretë”, të cilit i takonin laikët, por u përmbaheshin rregullave françeskane.

Mendohet se françeskanët u vendosën në hapësirat shqiptare që në kohën e themelimit të tyre. Kisha famullitare e dom Lleshit në Lezhë, e cila si datë ndërtimi mban vitin 1240, supozohet se është vendi ku vetë Shën Françesku kishte themeluar bashkësinë e parë. Sidoqoftë, lajmi i parë i verifikuar për praninë e françeskanëve në Arbëri është letra e papës Aleksandri IV (13 shkurt 1258). Në një dokument tjetër të vitit 1283 përmenden kuvendet françeskane në Tivar, Ulqin dhe Durrës. Kuvendet e françeskanëve ishin të shpërndarë gjatë gjithë bregdetit mes Tivarit dhe Durrësit. Nëpërmjet të Argjipeshkvisë së Tivarit dhe Ipeshkvisë së Kotorrit, françeskanët ishin të pranishëm edhe në Kosovë që nga shek. XIII. Ishin të pranishëm edhe nëpërmjet kolonive të Raguzës, Kotorrit, Ulqinit, Tivarit, Splitit, Venedikut, Zarës etj. Një ndër famullitë më të rëndësishme të këtij urdhri e ndeshim në Zym të Hasit. Pas Luftës së Parë Botërore, provinca françeskane shqiptare mbeti e ndarë në mes dy shteteve, Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Me kërkesë të Selisë së Shenjtë dhe në marrëveshje me qeverinë e atëhershme, françeskanët boshnjakë në vitin 1925 pranuan administrimin e famullive të Kosovës, si në Pejë, Zllakuçan, Zym dhe Glllogjan, si dhe administrimin e Shën Antonit në Gjakovë. Nga viti 1958 themelohet kuvendi i françeskanëve në Gjakovë. (Muhamet Mala)

FRANGU Emsale (1981-1999). Luftëtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmore. Lindi në Kaçanik. Ndërpreu mësimin në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Ferizaj, për t'u përfshirë në radhët e UÇK-së, në Brigadën 162 “Agim Bajrami” në Kaçanik, në ekipet mjekësore. Në mëngjesin e 9 prillit

të vitit 1999, policia dhe ushtria e Serbisë sulmoi Rakocin e Kaçanikut, me qëllim që t'i mbante jashtë qytetit njësitet e UÇK-së dhe ta siguronte grykën e Kaçanikut për qarkullim të lirë të forcave të veta. Luftëtarët e Brigadës 162 “Agim Bajrami”, e posaçërisht njësitet e batalionit II dhe njësitet e policisë ushtarake nuk u tërhoqën. Sulmi i forcave serbe e detyroi popullatën e qytetit të Kaçanikut të tërhiqej në malet mbi Kaçanik, që të strehohej nga granatimet. Duke mbrojtur popullatën civile në tërheqje, filloi një betejë e ashpër në mes të forcave serbe dhe UÇK-së. Në këtë betejë ranë E. Frangu me disa luftëtarë të tjerë të UÇK-së. Po të njëjtën ditë u vra edhe babai i saj, Izjadini. (Haki Kasumi)

FRASHËRI Abdyl (1839-1892). Ideator dhe njëri nga udhëheqësit kryesor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, politikan, diplomat. Lindi në fshatin Frashër, kryeqendër e krahinës së Dan-



ABDYL FRASHËRI

gëllisë në Përmet. Ishte i biri i Halid Frashërit, vëllai i madh i Naim dhe Sami Frashërit. Fëmijërinë dhe rininë e hershme e kaloi në fshatin e lindjes, deri në moshën 18-vjeçare, kur u vendos në Janinë. Fliste turqisht, greqisht, frëngjisht, por njihte edhe arabishten e persishten. U shqua si personalitet politik qysh më 1877, në kohën e Krizës Lindore. Si kryetar i Komitetit Shqiptar të Janinës, që u formua po atë vit, hartoi projektin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, me anë të një kryengritjeje çlirimtare antiosmane. A. Frashëri zhvilloi bisedime për një aleancë të mundshme me përfaqësuesit e Greqisë në korrik dhe në dhjetor 1877. Bisedimet dështuan, meqë Athina nuk e pranoi idenë e një Shqipërie të pavarur në kufijtë e saj etnikë. Në fund të vitit 1877, si deputet i Janinës në parlamentin e dytë osman, u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, që u formua në Stamboll (Komiteti i Stambollit). Si kryetar i tij, ai dha kontribut të rëndësishëm në përpunimin e platformës politike që adoptoi lëvizja kombëtare pas fitores ruse mbi Perandorinë Osmane dhe nënshkrimin të Traktatit të Shën Stefanit. Sipas ideve të A. Frashërit, në kushtet e krijuara nga prirjet

ekspansioniste të Rusisë, zgjidhja më e përshtatshme ishte krijimi i një shteti autonom shqiptar nën sovranitetin e sulltanit. Ai mendonte se një opsion i mundshëm do të ishte edhe krijimi i një vilajeti të bashkuar shqiptar, në kuadrin e Perandorisë Osmane, si fazë kalimtare deri në pavarësinë e plotë. Ishte njëri nga autorët kryesorë të platformës politike të Komitetit të Stambollit, të cilën e parashtrroi publikisht edhe me anën e artikujve që botoi në disa organe të shtypit evropian, gjatë pranverës së vitit 1878. Më pas ishte pjesëmarrës aktiv në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe u shqua si udhëheqës, organizator, diplomat dhe aktivist i saj. Veprimtarinë e tij kryesore e zhvilloi në viset e vilajetit të Janinës dhe të Kosovës, ku mori pjesë pothuajse në të gjitha kuvendet kryesore që u organizuan nga Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes Shqiptare, ose nga komitetet ndërkrainore të saj. Udhëhoqi krahun autonomist të lëvizjes. Në Kuvendin themelues të Lidhjes së Prizrenit u zgjodh kryetar i komisionit të punëve të jashtme. Ai përfaqësoi Toskerinë në Kuvendin e Parë të Dibrës (1 nëntor 1878), ku u miratua rezoluta me të cilën kërkohej zyrtarisht nga Porta e Lartë krijimi i vilajetit të bashkuar autonom të Shqipërisë. A. Frashëri ishte organizatori kryesor i Kuvendit të Prevezës (janar 1879), i cili arriti ta pengonte aneksimin e Çamërisë nga Greqia. Në pranverën e vitit 1879, bashkë me Mehmet Vrionin, organizuan një fushatë diplomatike në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha. Udhëhoqi gjithashtu Kuvendin Kombëtar të Gjirokastrës, që u shpreh për krijimin e shtetit autonom shqiptar me anën e lëvizjes së armatosur. Mbrojtí programin e Gjirokastrës në Kuvendin e Dytë të Dibrës. U bë anëtar i qeverisë së përkohshme që u formua në Prizren, në fillim të vitit 1881. Pas shtypjes së Lidhjes, u arrestua dhe u dënua me vdekje nga gjyqi special osman, por dënimi u kthye në burgim të përjetshëm. Vdiq në Stamboll. Eshtrat e tij u sollën në Tiranë më 1978. (Frashër Demaj)

FRASHËRI Kristo (1920-2016). Historian, profesor, akademik. Lindi në Stamboll. Në moshën shtatëvjeçare familja e tij u kthye në Tiranë. Pasi kreu shkollën e mesme, më 1940 u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Ekonomike në Universitetin e Firences në Itali. Më 1942 u burgos dhe u internua nga pushteti fashist, kurse më 1943 kaloi në radhët e



KRISTO FRASHËRI

njërive partizane, deri në çlirimin e vendit. Në vitet 1945-1952 punoi në Bankën e Shtetit Shqiptar. Ndërkohë, ndoqi studimet në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik (1951-1955). Nga viti 1953 ishte punonjës shkencor në Institutin e Shkencave, më 1955 në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë, ndërsa më 1957 pedagog në Fakultetin e Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Më 1997 u emërua zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka dhënë kontribute të shumta shkencore për të gjitha periudhat e historisë së Shqipërisë. Është autor i kapitujve që trajtojnë historinë mesjetare të Shqipërisë dhe periudhën e Rilindjes Kombëtare në “Historisë e Shqipërisë” në dy vëllime (1959, 1965). Më 1954 botoi një vështrim mbi jetën dhe veprën e Sami Frashërit dhe më 1958 një vështrim mbi Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Më 1964 botoi një “Histori të Shqipërisë”, një vështrim i përgjithshëm e i përmbledhur që nga parahistoria deri në vitin 1960 (botuar në disa gjuhë të huaja). K. Frashëri është autor i teksteve të historisë së Shqipërisë për shkollat e mesme gjatë viteve 70-80-të të shek. XX dhe bashkautor i “Historisë së Shqipërisë” botuar në frëngjisht (Lion, 1974). Më 1984 botoi monografinë “Abdyl Frashëri”. Është bashkautor dhe bashkëredaktor i “Historisë së Shqipërisë” (vëll.II, 1984) dhe bashkautor i “Historisë së popullit shqiptar” (vëll. II, 2002). Vepra të tjera të tij janë: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881” (1997), “Skënderbeu-jeta dhe vepra” (2002), “Historia e Tiranës” (2004), “Burimet historike shqiptare të shek.XV për Skënderbeun” (2005), “Himara dhe përkatësia etnike e banorëve të saj” (2005), “Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH 1878-1941” (2006), “Identiteti kombëtar shqiptar” (2006), “Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë” (2008), “Historia e qytetërimit shqiptar” (2008), “Bajroni në Shqipëri dhe takimet me Ali pashë Tepelenën” (2009), “Skënderbeu i shpërfytyruar” (2009), “Historia e Kosovës-Dardania” (2009), “E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit” (2010), “Historia e Dibres” (2012), “Etnogjeneza Shqiptare-veshtrim

historik” (2013), “Principata e Arbërisë 1190-1215” (2014), “Ahmet Zogu-Vështrim historik (2014)”; “Jeta e një historiani” (2014), “Historia e Çamërisë” (2015)”. K.Frashëri ishte laureat i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve, përfshirë edhe urdhrat “Mjeshtër i Madh” dhe “Nderi i Kombit”. (Teki Kurti)

FRASHËRI Naim (1846-1900). Poet i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në Frashër. U shkollua në vendlindje, në teqenë bektashiane, ndërsa mësimet e para në persisht i mori nga



NAIM FRASHËRI


U diplomua më 1870, duke përvetësuar dije e botëkuptime të ndryshme nga kultura e poezia e Lindjes dhe Europës si dhe filozofët e tyre. U punësua në Zyrën e Shtypit në Stamboll (1871), por turbekulozi e ktheu shpejt në vendlindje. Punoi në Berat e Sarandë, si nëpunës i perandorisë (1874-1877). Afrimi përmes Abdyllit me lëvizjen kombëtare, ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit, organizimi i degëve të Jugut në Frashër (1878), themelimi i “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip” (1879), kryesuar nga Samiu, e përfshinë plotësisht në lëvizjen politiko-kulturore të Rilindjes. Kthimi përfundimtar në Stamboll më 1882, ku punoi në Komisionin e Botimeve në Ministrinë e Arsimit, shënoi fillimin e një aktiviteti të pasur botimesh letrare e arsimore në disa gjuhë, sidomos me themelimin e revistës “Drita” (1884). Rolit prej korifeu kombëtar në letërsi e didaktikë i qëndroi besnik deri në fund. Vargëzimet e hershme, botimet e para didaskalike e poetike i sprovon në gjuhë të huaj: “Gramatika e persishtes sipas metodës së re” (1871), “Shpikje dhe zbulime” (1881), “Katër stinët” (1884). Spikat përmbledhja lirike në persisht “Ëndërrime” (1885). Në greqisht botoi “Dëshir” e vërtetë e shqiptarëve” (1886) dhe “Dashuria” (1895). Me mision edukues iluminist, hartoi libra mësimorë për shkollat shqipe: “E këndimit, çunavet këndonjëtojeja” (1886), “Istori e përgjithëshme për mësonjëtoret të para” (1886),

hojha i Frashërit. Më 1865 nisi studimet në gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Krahas gjuhëve e letërsive klasike studioi atë frënge, romantikët e iluministët e saj. Privatisht thelloi gjuhët e Lindjes, veçanërisht gjuhë e letërsi perse.

“Vjersha për mësonjëtoret e para” (1886), “Istori e Shqipërisë” (1899). Spikat pedagogjia moderne, besimi të shkencorja, ngritja morale dhe sfida me gjuhën. Tërësia e veprës poetike në shqip e bëri N. Frashërin të njëjti si poet kombëtar. Që me poemën e parë “Shqipëria”, shkruar më 1880, përvijohet fryma e krejt Rilindjes. Romantik i një formati ballkanik, tek ai sinkretizohet poezia me traktatin, poeti me atdhetarin, krijuesi me mësuesin, Perëndimi me Lindjen, përmes një gjuhe poetike të kthjellët e të rrokshme. Komunikimi receptiv qëndron në thelb të poetikës së tij, poetikë hibride, shkrije romantiko-ballkanike me simbolika orientale. E gjitha kjo, i fali veprës një qasje kolektive të panjohur më parë, prej poeti emancipues në lirikën shqipe, sidomos asaj atdhetare, të natyrës, por edhe meditative mistiko-religjioze. Poema lirike “Bagëti e Bujqësija” (1886), është poetikisht më e plotë. Krijim romantik me frymë bukolike virgjiliane, metaforë e “kthimit”, këndon mallin e vendlindjes si utopi e atdheut, me gjeografi etnike, ndërtim mozaikal e lirizëm simfonik, lejuar nga vargu 16-rrokësh naimjan. Përmbledhja “Luletë e verësë” (1890) thellon kërkimin lirik të njeriut si pjesë e harmonishme e botës dhe krijesë e Zotit. Këndej vijnë lirikat më të bukura refleksive, me frymë bektashiane, interpretimet panteiste, lumturia e ikshme e fatalizmit oriental, melankolia e vdekjes dhe e dashurisë, por dhe vetënjohja si emanacion i hyjnore të qenia. Korife edhe i bektashizmit shqiptar, si besim e bashkësi fetare, N.Frashëri nisi botimin e “Fletore e Bektashinjet” (1896). Mbas botimit të “Parajsa dhe Fjala fluturake”, (vjersha, 1894) dhe “Gjithësia” (1895), ai sprovoi gjininë epike me “Istori e Skënderbeut” (1898) dhe “Qerbelaja” (1898), duke synuar një apoteozë të lirisë, dinjitetit kombëtar dhe etikës njerëzore, me trajtë të ndërmjetme mes epikës dhe lirikës. Zgjedhje tipike romantike, “Istori e Skënderbeut” trajton qëndresën heroike të shqiptarëve kundër turqve. Vepra u bë popullore, duke rikthyer në kujtesën kolektive Skënderbeun si simbol të kombit. Pavarësisht tablove barletiane, pamjeve homerike e danteske të disa skenave, vepra rezonon fort me traditën epike perse firdusiane në gjuhën, rrëfim linear të pandërprerë, frymë mistike, prirje kontemplative e simbolikë. Këto tipare thellohen te “Qerbelaja”, ep religjioz i spiritualitetit dhe historisë së bektashizmit përmes jetës e sakrificës së Alidëve. Të dy epet

zhvillohen mes dualizmit etiko-fetar persian: drita kundër errësirës, e mira kundër së ligës, e bukura kundër së shëmtuarës. Poemat dhe lirikat e N.Frashërit, me lëvrimin e mundësive të shqipes në nivele të spiritualitetit, emotivitetit dhe ligjërimores ndikuan ngjizjen e një vetëdije kulturore mbarëkombëtare. Paradoksalisht, ai nuk mbajti dot një shkollë poetike por një frymë. Sinteza “frymë dhe poetikë” naimjane u rrok thellësisht vetëm nga poeti modern L. Poradeci. Ndërroi jetë në Stamboll më 20 tetor 1900. I sjellë në atdhe më 1937, prehet në Memorialin e Rilindasve në Tiranë. (Persida Asllani)

FRASHËRI Sami (1850-1904). Shkrimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në Frashër të Përmetit (Vilajeti i atëhershëm i Janinës), e vdiq në Stamboll. Mësimet fillestare



SAMI FRASHËRI

në turqishte, arabishte e persishte i mori nga hoxha i katundit. Pas vdekjes së babait, familja Frashëri u zhvendos në Janinë, vend në të cilin Samiu kreu gjimnazin grek “Zosimea”. Ai vazhdoi të mësojë arabishten e turqishten, përkundër mësimëve në greqishte të shkollës e të kulturës frënge e italiane që mori. Pasi kreu gjimnazin, shkoi në Stamboll e më vonë u dërgua në Tripoli, nga ku u kthye pas një viti. Pastaj, sërisht në Janinë e në Frashër, për t’u vendosur përfundimisht në kryeqytetin e perandorisë, deri në fund të jetës. Puna e Sami Frashërit në fushën e kulturës përfshin veprën e tij në disa gjuhë, si: shqip, turqisht, arabisht, përkthimet, punën studimore, tekste shkollore, fjalorë, enciklopedinë e njohur “Kamûs-ül Âlâm” (1889-1898), themelimin dhe drejtimin e gazetave e të revistave, si “Drita” e “Dituria”, punën në shoqëri nacionale e kulturore etj. Vepra kulturore, arsimore e letrare e S. Frashërit, e lidhur me shqiptarët, për nga gjuha ose për nga tematika, përfshin: “Besa ose fjala e dhënë “ (Besa yahud Ahde Vefa, 1874); “Shkronjëtoje e gjuhëse shqip” (1886), “Abetare e gjuhëse shqip” (1886), “Dheshkronjë” (1888) “Shqipëria ç’ka qenë, çështje e çdo të bëhetë?” (1899), si dhe faqe të tëra të “Kamûs-ül Âlâm”, të cilat u kushtohen personalitetëve e viseve shqiptare. “Shqipëria ç’ka qenë, çështje e çdo të

bëhetë?” e S. Frashërit është vepra themelore ideologjike e Rilindjes Shqiptare, që lidh e jep idetë e mëdha të nacionit e të jetës politike të tij, njësitë e identitetit historik, madje mitik dhe që e projekton të ardhmen e tij politike. Ndërsa drama “Besa ose fjala e dhënë”, veprën e tij të rëndësishme letrare, ka një temë shqiptare e një ambient shqiptar në Perandorinë Osmane dhe kap cepat e jetës së shqiptarëve në këtë perandori, shenja të jetës autentike e të etikës së vendit, si shenja identitare. Në këto vepra lexohen dy faqe themelore të veprës së Frashërit: ideologjia nacionale dhe temat letrare shqiptare. (Kujtim M. Shala)

FRAT VITA (Shek. XIV). Kryemjeshtri i Manastirit të Deçanit, arkitekt nga Kotorri. Në arkitraun e portalit jugor të narteksit gjendet mbishkrimi i gdhendur i arkitektit Frat Vitus (atë Vita). Për jetën dhe veprën e tij janë ruajtur njoftime në regjistrat e Arkivit Historik të Kotorrit. Dokumentet e vitit 1326 nxjerrin në dritë emrin e plotë të kryemjeshtrit të Manastirit të Deçanit (*dompni Vite Cutti*). Sipas një të dhëne nga noteriati i Kotorrit (1334), frat Vita ishte rektor apo kryemurg i kishës së Shën Mërisë në Gurdiq të Kotorrit (*Ego dompnus Vita Cutii, abbas et rector ecclesie s. Marie de Gurgite*), kishte lidhje me manastiret e Shën Mërisë në Rotec, si dhe me Manastirin e Shën Mërisë në Ulqin, punë që atëbotë në këtë pjesë të Adriatikut e bënin vetëm priftërinjtë arbërorë. Po ashtu është ruajtur e dhëna se atë Vita, më 18 skulptorë e gurëskalitës ndërtoi kishën e Manastirit të Deçanit. Është i njohur fakti se pjesën më të madhe të oficinave të gurgdhendësve të Tivarit, Ulqinit, Kotorrit, Raguzës, Korçulës, madje edhe të Zarës dhe Splitit, i mbanin mjeshtrit arbërorë. Njëri nga skulptorët që Miho (Mikel) Tivarasi, skulptor i njohur i shek. XIV. Krahas tij përmenden edhe dy skulptorë të tjerë me origjinë arbërore, Gjin Aleksi dhe Mark Nikollë Goga, mjeshtrë shumë të angazhuar në Raguzë. Për origjinën e tyre arbërore janë shprehur studiuesit e njohur të arteve në Dalmaci (R. Edelberger, G. Gelcich, T. G. Jackson etj). (Jahja Drançolli)

FRAZELOGJIA POPULLORE. Togfjalështa të qëndrueshëm, të formuar historikisht, që ndeshen shpesh në të folmen e popullit. Frazelogjizmat në terminologjinë gjuhësore njihen si frazeologji, ndërsa te folkloristët

edhe me emërtimet fraza, fraze, të thëna. Frazologjizmat, në kuptim të ngushtë lingvistik, janë nocione të shprehura me lokucione, togfjalësha të qëndrueshëm, në funksione të ndryshme morfologjike, të cilat kanë kuptim neutral, shprehje që ndeshen në të folmen e popullit, duke filluar që nga shprehjet metaforike, alegorike, krahasimet e deri te fjalët e urta, të cilat kanë kuptim figurativ e metaforik. Frazologjizmat konsiderohen pjesë përbërëse e trashëgimisë folklorike, të cilat pasurojnë edhe fondin leksikografik. Duke sjellë nuanca kuptimore e ngjyrimet emocionale të veçanta, japin forcë, larmi, shprehësi e bukuri ligjërimin në të folur dhe në të shkruar. Është mbledhur një lëndë e gjerë e frazeologjizmave, të cilat janë sistemuar dhe botuar sidomos edhe në fjalorë të veçantë, përfshirë edhe botimin e Institutit Albanologjik të Prishtinës “Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore” (1982). (Leontina Musa)

FRIDMAN Viktor (Friedman Victor) (1949-).

Gjuhëtar amerikan, sllavist, albanolog, ballkanolog. U diplomoi për gjuhë dhe letërsi ruse, ndërsa doktoroi në Universitetin e Çi-



VIKTOR FRIDMAN

kagos (1975) për kategoritë gramatikore të dëftores së maqedonishtes. Mbajti mësim në Universitetin e Karolinës së Veriut, ku ishte shef i departamentit të sllavistikës (1987-1993). Në vitin 1993 kaloi në Universitetin e Çikagos.

Botoi artikuj në revista të ndryshme shkencore. Interesimin për shqipen e nisi në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. Studioi edhe gjuhët e Kaukazit dhe ligjëroi si profesor vizitues në shumë universitete botërore, përfshirë Universitetin e Prishtinës. Është laureat i shumë çmimeve në Maqedoni dhe në Bullgari dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Maqedonisë, i “Matica Srpska”, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Universiteti i Shkupit e ka shpallur “Doctor Honoris Causa” më 2007. Gjatë luftërave në Jugosllavi ishte analist i lartë politik i UNPROFOR-it (1994), këshilltar i Grupit Ndërkombëtar të Krizës-ICG (1997) dhe bashkëpunëtor i Institutit Amerikan për Paqe

(1999-2000). Është marrë kryesisht me çështje të kategorive gramatikore të sistemit foljor, të gjuhëve në kontakt dhe të sociolinguistikës në gjuhët e Ballkanit dhe të Kaukazit. Në Kosovë u botua përmbledhja e punimeve të tij “Studime për shqipen dhe gjuhët e tjera të Ballkanit” (Studies on Albanian and Other Balkan Languages, “Dukagjini”, 2004). Ndër publikimet e tjera veçohen: “Maqedonishtja” (Macedonian, 2002), “Turqishtja në Maqedoni dhe më gjerë: Studime në kontakt, tipologjia dhe të tjera fenomene në Ballkan dhe Kaukaz” (Turkish in Macedonia and Beyond: Studies in Contact, Typology, and Other Phenomena in the Balkans and the Caucasus, 2003), “Bazat e gjuhës lak” (Očerki laksogo jazyka, 2011), “Studime maqedonase” (Macedonian Studies, 2015) etj. (Lindita Rugova)

FROJNDLIH Leo (Leo Alexander Freundlich) (1875-1953).

Publicist dhe diplomat austriak, autor i librit “Golgota shqiptare” (Albanian Golgotha). Lindi në një familje hebreje në



LEO FROJNDLIH

Bielitz-Biala, në atë kohë pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze. Fillimisht punoi si botues në Aussig (tani Ústí nad Labem në Republikën Çeke). Më pas u zhvendos në Vjenë, ku në vitet 1911-1912 pati edhe kontaktet e para me shqiptarët. Më 1912 nis grumbullimin dhe shpërndarjen e një koleksioni të shkrimeve në shtyp për Shqipërinë, të titulluar “Korrespondenca shqiptare” (Albanische Korrespondenz). Me anën e saj, L. Freundlich informoi autoritetet dhe opinionin austro-hungarez për ngjarjet e ndodhura në Shqipëri deri në gusht 1914. Në vitin 1913 botoi veprën e tij më të njohur “Golgota shqiptare” (Albaniens Golgotha), përmes së cilës njohu opinionin publik me reprezaljet serbe gjatë pushtimeve në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni gjatë vitit 1912. Në vitet e Luftës së Parë Botërore u aktivizua në Shqipëri, me trupat austro-hungareze. Në kohën e Mbretërisë Shqiptare (1928-1939) u punësua nga Mbreti Zog I si konsull nderi dhe sekretar shtypi në Vjenë. Në prag të Luftës së Dytë Botërore u zhvendos në Zvicër, ku bashkëpunoi me delegacionin shqiptar në Lidhjen e Kombeve. Pas Luftës së

Dytë Botërore u kërkoi autoriteteve shqiptare të emërohej sërish konsull nderi i Shqipërisë në Vjenë, por u refuzua. Vdiq në Toneks afër Gjenevës, në Zvicër. (Ledia Dushku)

FRONTI ANTIFASHIST I GRAVE (FAG). Organizatë politike e gruas në Kosovë. Nga lëvizja e grave antifashiste të paraluftës u formua organizata masive e FAG-ut, e cila gjatë luftës kishte për detyrë t'i bashkojë dhe t'i organizojë gratë në Lëvizjen Antifashiste. Femrat gjatë Luftës Antifashiste punonin në prapavijë, por kishte edhe anëtare të Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ), të Këshillave Nacionalçlirimtare, të aradheve partizane etj. FAG-u u masivizua në periudhën pas kapitullimit të Italisë, deri në maj 1945. Lëvizja e grave ishte aktive në të gjitha ato vende, ku PKJ kishte arritur t'i tubojë femrat. U formuan edhe këshillat e FAG-ut, kryesisht në vendbanime serbe dhe malazeze. Pas Luftës së Dytë Botërore organizata u zgjerua nëpër të gjitha rrethet e Kosovës dhe u zgjodhën delegatët për Konferencën Krahinore të FAG-ut. Konferenca Themeluese e FAG-ut u mbajt në Prishtinë më 22 mars të vitit 1945, në të cilën morën pjesë 400 delegatë dhe mysafirë. Konferenca zgjodhi Këshillin Krahinor të FAG-ut për Kosovë dhe Dukagjin, ndërkaq në sekretariat u zgjodhën: Sabrije Vokshi (kryetare), Mileva Llaliq (nënkryetare) dhe Fetije Bajraktari, Danica Baboviq, Mense Shaqiri dhe Jelica Vuliq (anëtare). FAG-u më pas veproi në kuadër të Frontit Popullor. (Sulltane Ukaj)

FRONTI I SREMIT (1944-1945). U formua në fund të vitit 1944 nga komanda e ushtrisë gjermane, e cila po tërhiqej nga Beogradi. Për armatën gjermane ky front pati rëndësi të madhe, ngase aty mbrohej rruga e vetme për tërheqjen e Grupit E të Armatave përmes Sarajevës e Sllavonski Brodit në Panoni. Për Aleatët, Fronti i Sremit pati rëndësi për depërtimin e Ushtrisë së Kuqe në Hungarinë Jugperëndimore.

Për shpërthimin e Frontit të Sremit, Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë (UNÇJ) mobilizoi njësitë të shumta edhe nga Kosova. Në janar të vitit 1945, Shtabi Suprem i UNÇJ-së dhe shtabet e Serbisë e të Maqedonisë urdhëruan të dërgoheshin në veri të Jugosllavisë brigadat VI, VII dhe VIII kosovare, pastaj Brigada IV (VII) shqiptare e Maqedonisë, si dhe Brigada VII

plotësuese e Preshevës. Brigadat me shqiptarë, që marshuan drejt Veriut, numëronin fillimisht rreth 16,500 veta. Rruga e tyre drejt Veriut u bë në rrethana shumë të rënda. Gjatë rrugës nëpër Serbi ata u "riorganizuan" dhe u çarmatosën, kurse pjesa më e madhe e kuadrit komandues u demobilizua dhe u kthye në Kosovë dhe në Maqedoni. Ushtarët e çarmatosur e të pambrojtur, të veshur dobët, u ndanë në grupe e kolona të vogla. Ushqimi i dobët, kushtet e rënda të rrugës ndikuan që ndër këta ushtarë të shfaqej sëmundja e tifos, nga e cila gjatën vdekjen shumë prej tyre.

Luftëtarët e Brigadës VI të Kosovës, të dërguar për në Frontin e Sremit, gjatë qëndrimit në Vërshac, Paçevë e Kikindë, si rezultat i kushteve të rënda dhe i provokimeve, shfaqën pakënaqësi, e cila u shoqërua me kërkesën për t'u kthyer në Kosovë. Rreth kësaj kërkesë u bashkuan rreth 540 veta. Të gjithë ata morën rrugën drejt Jugut dhe në Alibunar (Vojvodinë) kaluan Danubin, gjë që i alarmoi repartet që i përcillnin, madje edhe Divizionin XXVII të Armatës së Kuqe të BRSS-së, e cila vepronte në Frontin e Sremit. Pas lokalizimit të vendqëndrimit të këtij grupimi nga avionët sovjetikë, ata u rrethuan dhe, duke mos pasur rrugëdalje tjetër, u dorëzuan. Organet ushtarake jugosllave, 12 veta që i konsideruan si organizatorë të rebelimit, i dënuan me vdekje, kurse të gjithë të tjerët i shpërndanë menjëherë nëpër formacionet ushtarake që vepronin në Serbi, Kroaci, Bosnjë dhe në Slloveni. Ndërkaq, pjesëtarët e Brigadës IV (VII) shqiptare të Maqedonisë korrën suksese të mëdha në luftë kundër forcave gjermane. Luftëtarët e kësaj brigade u shquan sidomos në luftimet për çlirimin e Vinkovcit e Vukovarit, njëjës kryesore hekurudhore jugosllave, pastaj në Travnik etj. Peripeci të shumta kaloi edhe Brigadën VII plotësuese e Preshevës më 2,500 pjesëtarë, nën komandën e Skënder Hasanit (Presheva). Ai u angazhua që luftëtarët e tij shumë prej të cilëve u kishte rënë tifoja, për shkak të kushteve të rënda të mos i dërgonte në frontin e luftës, mirëpo u denoncua për sabotim dhe u dënua me 20 vjet burg. (Muhamet Shatri)

FRUTHI. Është sëmundje ngjitëse akute me etiologji virale, që karakterizohet me shkallë të lartë të kontagiozitetit mbi 95%. Në vendet e zhvilluara nga fruthi sëmundjen të gjithë personat, të cilët nuk janë imunizuar,

kurse në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim sëmundja prek kryesisht fëmijët parashkollorë dhe shkollorë. Fruthi shkaktohet nga virusi i fruthit që është *paramyxovirus* dhe është i ndjeshëm në ambientin e jashtëm. Pas periudhës së inkubacionit prej 9-11 ditë, fillojnë shenjat e sëmundjes: temperatura e lartë, ngjirja e zërit, kollë dhe me njollat e koplikut në mukozën e faqeve, në lartësinë e dhëmbëve të poshtëm molarë. Më pas shfaqen ekzantemat makulopapuloze në tërë trupin. Te fëmijët e pavaksinuar dhe të paushqyer mirë, sidomos me mungesë të vitaminës, fruthi shoqërohet me komplikime: otitis media (7%), pneumoni (6%), encephalitis (0.1%), ndërsa panencefaliti sklerotik subakut është shumë i rrallë. Sipas statistikave GAVI-it, çdo vit në botë nga fruthi vdesin rreth 800,000 fëmijë, kryesisht të pavaksinuar dhe të moshës nën 5 vjeç. Gjatë periudhës 1960-1970 nga pasojat e fruthit në Kosovë vdiqën 426 fëmijë, kurse pas vaksinimit për periudhën dhjetëvjeçare 1971-1981, vdiqën 184 fëmijë, të gjithë të pavaksinuar. Në Kosovë epidemia e fruthit u paraqit sërish në vitin 1997, nga 3931 raste të regjistruara me këtë sëmundje, 7 prej tyre përfunduan me vdekje. Pas organizimit të fushatave masive të imunizimit, raste të fruthit nuk pati në Kosovë që nga viti 2000. (Isme Humolli)

FUQIA PUNËTORE. Janë personat mbi moshën 16-vjeçare, deri në moshën e pensionimit, që janë të punësuar ose në kërkim të punës. Në këtë përkufizim, të punësuarit janë ata persona që gjatë javës referuese kanë kryer çfarëdolloj pune, me pagesë monetare ose me pagesë tjetër, ose për përfitim familjar, përfshirë edhe personat që përkohësisht mungojnë nga puna. Ndërkaq, të papunët janë personat që gjatë javës referuese nuk kanë qenë të punësuar, por kryejnë aktivitete që çojnë në gjetjen e vendit të punës dhe janë të gatshëm të pranojnë një punë, nëse u ofrohet një e tillë. Personat që nuk janë të punësuar dhe nuk janë në kërkim të punës trajtohen si persona jashtë fuqisë punëtore. Në parim, në fuqinë punëtore hyjnë të punësuarit dhe të papunët. Raporti i fuqisë punëtore ndaj popullsisë në moshë pune, që është popullsia mbi moshën 16-vjeçare deri në moshën e pensionimit paraqet normën e pjesëmarrjes në tregun e punës. Kjo njihet ndryshe si kapaciteti njerëzor prodhues i një vendi. Numri i të punësuarve dhe i të papunëve në kuadër të

fuqisë punëtore, si dhe karakteristikat mesatare të këtyre dy grupeve ndryshojnë vazhdimisht. Në Kosovë, sipas të dhënave të vitit 2014, rreth dy të tretat e popullsisë rezidente (1,811,521 persona) janë në moshë pune (1,202,489 persona). Prej tyre, 41,6% (500,251 persona) janë fuqi punëtore apo marrin pjesë në tregun e punës. Nga ky numër, 64,7% (323,508 persona) janë të punësuar dhe 35,3% (176,743 persona) janë të papunë. Për meshkujt norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 61,8% (apo 371,000 persona), ndërkaq për femrat është 21,4% (apo 129,000 persona). Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është më e larta për grupmoshën 30-34 vjeç me 55% të kësaj grupmoshe që marrin pjesë në fuqinë punëtore. (Avdullah Hoti)

FURIQI Petro (1875-1936). Gjuhëtar, albanolog dhe akademik. Lindi në ishullin Salamina, afër Athinës, Greqi. Duke qenë vetë arbëresh nga Greqia (arvanit), Furiqi ishte ndër studiuesit dhe njohësit më të shquar të gjuhës, kulturës dhe origjinës arvanitase. Ishte albanolog i shquar i kohës së tij. Drejtoi Arkivin e Folklorit në kuadër të Akademisë së Shkencave të Athinës. Studimet e Furiqit u përqendruan në fushën e gjuhësisë e më pak të historisë. Dy veprat e tij të rëndësishme, njëra për dialektet, "Dialekti i shqipës së Greqisë në Atikë" (1929) dhe tjetra për toponiminë, "Kontribut në toponiminë e Atikës" (1933), janë ndihmesa themelvënëse për njohjen e të folmeve shqipe dhe toponiminë e asaj treve. Botoi edhe një varg përrallash arvanitase të mbledhura në 11 fshatra të ndryshme. (Ardita Berisha)

FUSHA Abdylatif (1931-). Mjek, internist, kardiolog, profesor universitar. Lindi në Podujevë, shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prishtinë. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1962). Specializimin nga mjekësia interne e mbaroi gjithashtu në Beograd, ndërsa subspecializimin nga kardiologjia në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Një kohë punoi si mjek në Dragash. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 1980 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1971 u zgjodh asistent i lëndës mjekësia interne në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas merr edhe titujt përkatës

universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar i po kësaj lënde. Për një periudhë të gjatë drejtoi repartin e kardiologjisë në Klinikën Interne. Ishte pedagog i shumë gjeneratave të studentëve të mjekësisë, të specializantëve dhe të subspecializantëve të mjekësisë interne. Ka publikuar një sërë punimesh profesionale dhe shkencore. (Bedri Zahiti)

FUSHA E PEJËS. Fushë në veri të Rrafshit të Dukagjinit. Në pjesën veriore mbyllet me malin e Moknës, në perëndim me Bjeshkët e Nemuna, në lindje me malet qendrore të Kosovës, kurse në jug shtrihet deri te gryka e Drinit në Kramovik dhe Dushkajë, me gjatësi rreth 30 km dhe gjerësi 25 km. Përbëhet nga shkëmbinj të moshave të reja (pliocen-kuaternari), të cilat përfaqësohen nga rërë, zhavorre, argjilë, sedimentet liqenore etj. Lartësia mbidetare prej 400-600 m, relievi është mjaft i përthyer, për shkak të rrjetit të dendur lumor. I gjithë relievi pjerrësohet në drejtim të Drinit të Bardhë. Karakterizohet me klimë të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore mbi 10°C, kurse reshjet deri 800 mm. Hidrografia është mjaft e pasur dhe dallohet si për ujërat nëntokësore, ashtu edhe rrjedhjet lumore. Lumenjtë kryesorë janë: Drini i Bardhë, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, lumi i Istogut, i Klinës etj. Përhapje më të madhe të tokave kanë ato aluviale, deluviale dhe të mesme të kuqërremta. Në pjesët kodrinore bimësia përfaqësohet nga kati i dushkut, kurse në pjesën më të madhe (fushore) është zëvendësuar me atë të kultivuar. Qendrat më të mëdha janë: Peja, Deçani, Klina, Istogu, Juniku etj. (Valbon Bytyçi)

FUSHA E PRIZRENIT. Fushë në jug të Rrafshit të Dukagjinit. Rrethohet me Malet e Sharrit në jug, Pashtrikun dhe malet e Hasit në perëndim, me malet e Carralevës dhe Milanovcit në veri. Ka shtrirje veriperëndim-juglindje me gjatësi rreth 24 km, kurse gjerësi 11-28 km, sipërfaqja rreth 450 km². Në aspektin gjeologjik përbëhet nga formacione të pliocenit të sipërm dhe kuaternarit, të cilat përfaqësohen nga aluvionet, proluvionet, sedimentet liqenore etj. Në reliev hasen depozitime liqenore, si gjurmë të liqenit të dikurshëm, të cilat sot gjenden në anët e luginave lumore. Relievi ka lartësia mbidetare mes 300 dhe 500 m dhe pjerrësohet në drejtim të Drinit të Bardhë. Karakterizohet me klimë

më të nxehtë dhe më të lagësht se të gjitha pjesët e Kosovës, që është reflektuar me ndikimin e detit Adriatik. Temperatura mesatare vjetore 10-11°C, kurse sasia e reshjeve mes 700-800 mm. Dallohet me rrjet të pasur hidrografik. Arteria kryesore lumore është Drini i Bardhë me degët Toplluha dhe Lumëbardhi i Prizrenit. Karakterizohet me toka me bonitet të lartë, ku dominojnë tokat aluviale, smonica të mesme të kuqërremta etj. Bimësia në pjesën më të madhe përfaqësohet me bimësinë e kultivuar. Qendrat më të mëdha urbane janë Prizreni dhe Suhareka. (Valbon Bytyçi)

FUSHA Jahja (1919-1944). Veprimtar i lëvizjes antikomuniste në Kosovë. Lindi në Podujevë. Shkollën Normale e kreu në Shkup. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore u emërua nënprefekt i Podujevës. Nga ky post organizoi dhe udhëhoqi forcat vullnetare në mbrojtjen e brezit kufitar mes Llapit e Serbisë, nga çetnikët e partizanët serbë. Ishte delegati më i ri në kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe kryetar i Komitetit Qarkor për Podujevë. Në luftimet e zhvilluara më 12 gusht 1944, drejtoi forcat shqiptare që thyen sulmin e partizanëve serbë në sektorin Çuka e Drazhnjes-Pollatë. Pas tërheqjes së forcave gjermane dhe depërtimit të UNÇ-së në Podujevë e rrethinë në fund të vitit 1944, vazhdoi qëndresën kundër pushtetit të ri. Nuk u largua as bashkëshortja e tij gjermane, Lucia Gio-Fusha, të cilën e vranë edhe pse ishte shtatzënë. Pasi u kap nga OZN-a, u ekzekutua pa gjyq në Taukbahçe të Prishtinës. (Muhamet Shatri)

FUSHË-KOSOVA. Qytezë në perëndim të Prishtinës, rreth 5 km nga kryeqendra e Kosovës. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar. Ka rreth 24,000 banorë. Në vitin 1862 këtu vendosen disa familje çerkeze. Në mes dy luftërave botërore në këtë lokalitet u vendosen 142 familje kolonësh serbë. Nëpër këtë vendbanim kalon rruga që lidh Prishtinën me Rrugën e Kombit dhe me Kosovën Qendrore dhe Kosovën Perëndimore. Në vitin 1936, kur ndërtohet dhe lëshohet në qarkullim hekurudha për Pejë, stacioni merr emrin Fushë-Kosovë dhe më pas edhe vendbanimi fillon të quhet me këtë emër. Hovin më të madh të zhvillimit qyteza e merr kur bëhet një e komunikacionit hekurudhor, sidomos pas ndërtimit të vijës hekurudhore Fushë Kosovë-Nish. Në të dy



FUSHË-KOSOVA

anët e rrugës për Prishtinë filluan të ngrihen disa dyqane tregtare dhe zejtare. Përpos zonës individuale dhe shtëpive të banimit, u ndërtuan edhe objektet e infrastrukturës, si shkolla fillore, qendra shëndetësore për personelin hekurudhor, disa reparte industriale etj. Në vitin 1928 vendbanimi kishte 63 shtëpi me 244 banorë serbë e malazezë; në vitin 1981 kishte 2,500 shtëpi me 12,480 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Fushë Kosovë jetojnë 18,515 banorë. Nga objektet e standardit shoqëror, qyteza ka 3 shkolla nëntëvjeçare, 2 shkolla të mesme, qendrën e mjekësisë familjare, spitalin, shtëpinë e kulturës etj. Në qytezën e Fushë Kosovës janë ngritur reparte të ndryshme industriale, kryesisht të industrisë ushqimore (fabrika të miellit, qumështorja, thertorja etj.), shumë punëtori zejtare, qendrat e mëdha tregtare etj. (Nazif Gashi)

FUSHË-KOSOVA (komuna). Komunë në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës. Shtrihet rreth 4 km në perëndim të Prishtinës, me të cilën tanimë përbën një vazhdimësi urbane. Territori i komunës ka sipërfaqe prej 96 km², lartësia mesatare mbidetare e territorit të kësaj komune është 530 m. Në lindje kufizohet me komunën e Prishtinës, në jug me komunën e Lipjanit, në perëndim me komunën e Drenasit dhe në veri me komunën e Obiliqit. Është një e rëndësishme e komunikacionit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Relievi është kryesisht fushor, rreth lumenjve Sitnica dhe Drenica, kurse një pjesë e vogël e territorit është kodrinor-malor (Goleshi, Blinishta dhe Gospoja). Dominojnë tokat e zeza (smonicat), ndërsa rreth lumenjve janë tokat aluviale, të cilat ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Klima është e mesme kontinentale.

Nëpër territorin e kësaj komune kalon lumi Sitnica, në të cilën derdhen lumenjtë: Drenica, Graçanka dhe Prishtevka. Kushtet relativisht të mira natyrore, pozita e volitshme gjeografike dhe pasuritë natyrore kanë mundësuar popullimin e hershëm të territorit. Në fund të shekullit XIX (1860-1864), disa familje çerkeze vendosen në disa fshatra të kësaj komune, si në Sllatinë të Madhe, Miradi të Epërme, Bardh i Madh, Fushë-Kosovë, Uglar etj. Gjatë viteve 1877/78 këtu vendoset edhe popullsia shqiptare e shpërngulur nga Sanxhaku i Nishit. Popullsia shqiptare vendoset kryesisht në Fushë-Kosovë, Sllatinë të Madhe, Sllatinë të Vogël, Vragoli, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Uglar etj. Edhe gjatë Luftës së Parë Botërore popullsia shqiptare i nënshtrohet dhunës dhe terrorit me qëllim të shpërnguljes. Gjendja e vështirë ekonomike vazhdoi me okupimin e serishëm serb të Kosovës në vitin 1918 dhe zgjati deri në vitin 1941. Gjatë kësaj periudhe në Fushë-Kosovë u vendosën kolonët serbë, si në Sllatinë të Madhe, Graboc, Miradi të Epërme, Krivovë, Harilaq etj. Pas Luftës së Dytë Botërore bëhen disa përparime në zhvillimin ekonomik dhe arsimor. Pas vitit 1974 vendbanimet e kësaj treve fillojnë të marrin një fizionomi të re urbane. Kjo është periudha e transformimit ekonomik dhe social të kësaj komune.

Pozita e volitshme gjeografike, pasuritë natyrore, afërsia me Prishtinën kanë ndikuar në rritjen e shpejtë demografike të komunës së Fushë-Kosovës. Ajo u shndërrua në qendër industriale dhe një të komunikacionit. Kjo solli rritjen e shpejtë të popullsisë. Sipas regjistrimit të vitit 1991 (vlerësim) në komunën e Fushë-Kosovës jetonin 32,500 banorë. Sipas shënimeve nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Industri e Tregti, komuna në vitin 2001 kishte 18 vendbanime me 4,679 shtëpi dhe 35,868 banorë, 19 shkolla dhe shumë objekte biznesi në qendër dhe në vijat kryesore të komunikacionit rrugor. Sipas regjistrimit të vitit 2011 komuna e Fushë-Kosovës ka 35,733 banorë. (Nazif Gashi)

FUTBOLLI. Është loja më popullore në Kosovë, sikurse në vendet e tjera të botës. Ndeshja e parë e futbollit në Kosovë supozohet të jetë zhvilluar në Prizren në vitin 1919 ndërmjet ushtarëve austriakë. Në maj të po këtij viti, në fshatin Banjskë të Vushtrrisë, gjatë një ekskursioni të përbashkët të nxënësve të

shkollave fillore shqipe të Vushtrrisë dhe të Mitrovicës (në çifligun e familjes Badivuku) u zhvillua edhe një ndeshje futbollit. Topi i parë i futbollit u paraqit në Prizren në vitin 1920, ndërsa më 1921 u themelua klubi “Terbejeli Bedenije Rebap Klub”, por veproi shkurt, pasi pushteti i atëhershëm ia ndaloi veprimtarinë. Që nga viti 1922 u themeluan klubet e para në Prizren, Prishtinë dhe Gjakovë. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, futbollit në Kosovë mori format më të organizuara. Në vitin 1948 u themelua Federata e Futbollit e Kosovës, e cila veproi nën ombrellën e ish-RSFJ-së deri në vitin 1991. Gjatë kësaj periudhe Kosova kishte ligën e vet, ndërsa skuadrat më në zë ishin “Prishtina”, “Trepça”, “Liria”, “Vëllaznimi”, “Cërvena Zvezda”, “Budućnost”, “Ramiz Sadiku” e ndonjë tjetër, që merrnin pjesë në garat e ligave elite të asaj kohe. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe instalimi i pushtetit okupues serb në Kosovë brenda ditës i largoi nga fushat e veta edhe futbollistët. Si kundërpërgjigje u bë themelimi i Federatës së Futbollit të Kosovës, e pavarur nga Jugosllavia. Kryetar i parë i Federatës së pavarur u zgjodh Agim Bytyçi, ndërsa më pas në këtë post ishin edhe Rexhep Abdullahu dhe Sabri Hashani. Më 13 shtator të vitit 1991 në stadiumin e Flamurtarit, në Prishtinë, u zhvillua ndeshja e parë zyrtare e kampionatit të pavarur të Kosovës, ndërmjet “Prishtinës” dhe “Flamurtarit”. Kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës aktualisht është Fadil Vokrri. Shumë futbollistë të Kosovës luajnë në skuadrat elite të ligave më të forta europiane. Një numër syresh kanë mbrojtur dhe vazhdojnë të mbrojnë ngjyrat

e përfaqësueses së Shqipërisë (Riza Lushta, Naim Kryeziu, Arian Beqaj, Besnik Hasi, Lorik Cana, Armend Dallku, Debatik Curri, Besart Berisha, Mehmet Dragusha, Saimir Ujkani, Etrit Berisha, Valdet Rama, Mërgim Mavraj, Taulant Xhaka, Shkëlzen Gashi, Alban Meha, Ermir Lenjani, Amir Abrashi etj.) dhe të Zvicërs (Valon Behrami, Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka). Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), që nga viti 2016, është anëtare e Federatës Botërore të Futbollit (FIFA) dhe e Konfederatës Europiane të Futbollit (UEFA). (Xhavit Kajtazi)

FYLLI Dibran (1956-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Açarevë të Skënderajit. Më 1984 u diplomua në Akademinë për Teatër, Radio, Film dhe Televizion në Lubjanë. Ishte pjesëtar i radhëve të para të UÇK-së dhe udhëheqës i njësitit “Shkoza 2” në Açarevë. Mori pjesë në shumë beteja dhe u plagos në betejën e Llapushnikut në maj të vitit 1998. Më 1999 themeloi trupën artistike ushtarake “Hamëz Jashari” të UÇK-së. Është skenarist dhe organizator i manifestimit përkujtimor “Ai është i gjallë”, tani “Epopeja e UÇK-së”, që mbahet më 5, 6 dhe 7 mars, e njohur si “Nata e zjarreve”. Është ideator edhe i një sërë manifestimesh kulturore kushtuar figurave të njohura dhe ngjarjeve të rëndësishme të luftës së UÇK-së. U arrestua nga UNMIK-u dhe pas 4 vjetësh burg u lirua si i pafajshëm. Ka botuar një sërë veprash letrare-poetike, kryesisht për luftën dhe dëshmorët e UÇK-së. (Ruzhdi Jashari)

G

GABELËT. Emërtim për pjesëtarët e komunitetit joshqiptar që çonte jetë endacake, pjesëtarë të popullatës nomade romë. Përdoret edhe në kuptim derogator. Emërtimi gabel është i përhapur në gegërishten veriore, por nuk haset tek autorët e vjetër. Ka përdorim më të gjerë në Dukagjin. Gabelët u përkasin romëve nomadë. Prania e romëve në Ballkan është e dëshmuar që nga shekulli XIV. Se kur kanë ardhur për herë të parë në Kosovë nuk mund të konstatohet. Njihen edhe si arixinj ose cergarë. Vendoseshin në periferi qytetesh me lumenj. Janë marrë me zejen e kallajxhinjve, teneqexhinjve, saraçëve dhe me stërshitje të frutave dhe perimeve. (Ganimet Klaiqi)

GABINSKI Marku (Marcu Gabinschi (1932-)). Gjuhëtar, ballkanolog, romanist, leksikograf. Lindi në Odesa, ku përfundoi shkollën e mesme (1948), studimet për romanistikë i kreu në Universitetin e Leningradit. Nga 1953 punoi në Institutin e Historisë, të Gjuhës dhe të Letërsisë të degës së Akademisë së Shkencave të BRSS-së në Moldavi (nga viti 1961 Akademia e Shkencave të Republikës Sovjetike Socialiste të Moldavisë). Botoi tri monografi për çështjen e paskajores në gjuhën shqipe dhe gjuhët e tjera ballkanike: “Zhvillimi i infinitivit si proces gjuhësor ballkanik dytësor. Në materialet e gjuhës shqipe” (Vozniknovenie infinitiva kak vtoričnyj balkanskij jazykovoij process. Na materiale albanskogo jazyka, Leningrad 1967), “Zhvillimi dhe zhdukja e infinitivit primar të shqipes. Rreth problemit të infinitivitit në gjuhët ballkanike” (Pojavlenie i utrata pervičnogo albanskogo infinitiva. K probleme infinitivnosti v balkanskij jazykah, Leningrad 1970) dhe “Infinitivi ballkanik - etapa e re e diskutimit. Vëzhgim antikritik” (Balkanskij infinitiv-očerednoj

etap diskussii. Antikritičeskij obzor, Kishinau 2008). Vëmendje u kushtoi problemeve të gramatikës dhe të fjalëformimit të rumanishtes dhe moldavishtes. Hartoi edhe dy fjalorë etimologjikë për gjuhën rumune (1998, 2007). (Marija Morozova)

GABULEO. Vendbanim i periudhës romake. Gjendej në rrugën antike Lissus-Naissus dhe është shënuar si stacion rrugor në hartën Tabula Peutingeriana (shek. II). Gjendet në radhë me stacionet e tjera: Ad Fines XX-Vindenis XX-Viciano XXV-Theranda XXV-Gabuleo XXX, bashkë me distancat në milje romake në mes tyre. Disa studiuues e vendosin te Kukësi i sotëm, mbështetur në distancën ndërmjet stacioneve dhe në bazë të relievit. (Emine Kalaja-Hajdari)

GACAFERRI Jusuf (1943-2003). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për inxhinieri elek-



JUSUF GACAFERRI

trike në Universitetin e Beogradit (1966). Studimet e magistraturës i kreu në Universitetin e Zagrebit, disertacionin e mbrojti në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1997). Filloi të punojë më 1965 në ndërmarrjen e elektrokeonomisë në Prishtinë, më 1968 u zgjodh asistent në UP, më pas ligjërues për lëndët matjet elektrike dhe makinat llogaritëse. Ushtrroi funksione drejtuese në fakultet dhe në sektorët e tij. Në vitin 1985 për një kohë kaloi me punë në Elektrokeonominë e Kosovës, në detyrën e udhëheqësit dhe dispeçerit

kryesor të bashkësisë punuese për eksploitim dhe udhëheqje të sistemit elektroenergjetik të Kosovës. Është autor i tekstit universitar “Bazat e matjeve elektrike”, i një sërë dispensave për studentët e këtij fakulteti, si dhe i disa teksteve për shkollat e mesme profesionale. Është autor dhe bashkautor i artikujve dhe referateve në revista e përmbledhje studimesh brenda dhe jashtë vendit. (Ali Gashi).

GAFURRI Nazim (1882-1928). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, deputet i Prishtinës në Parlamentin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (SKS). Lindi në Prishtinë. Në vitin 1912



NAZIM GAFURRI

iu bashkëngjit kryengritësve kundër Perandorisë Osmane dhe mori pjesë në çlirimin e Prishtinës. Nga viti 1915 ishte aktivist i organizatës “Bashkimi”, e cila udhëhoqej nga Hasan Prishtina, ndërsa më 1920 bëhet anëtar i “Xhemietit”. Zhvilloi betejë të ashpër politike kundër pushtetit të Mbretërisë së SKS-së. Nga viti 1920 e deri në vdekje ishte anëtar i Këshillit të qytetit të Prishtinës. Deputet i Prishtinës në Parlamentin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (1921-1925). Denonconte barbaritë e pushtetit serb ndaj popullsisë shqiptare dhe kërkonte shkolla në gjuhën amtare, sikurse për etnitetet e tjera joslave (gjermanët, hungarezët e të tjerë). Denoncoi masakrat e ushtrisë dhe të xhandarmërisë serbe në Keqekollë dhe Prapashticë (janar 1921) dhe dërgoi telegrame njoftimi në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, në Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në Shkodër dhe në Qeverinë e Shqipërisë. Botoi të dhëna për këtë masakër në gazetën “Hak” në Shkup. Më 1 shkurt 1921 organizoi protestën e deputetëve shqiptarë në Parlamentin e Mbretërisë të SKS-së, duke kërkuar mosbesim ndaj qeverisë, me motivacion se organizonte shfarosjen sistematike të elementit shqiptar në Mbretërinë e SKS-së. Më 1924 reagoi kundër masakrave të xhandarmërisë serbe në rrethin e Vushtrisë, të cilët vranë 23 civilë shqiptarë, në mesin e tyre 18 fëmijë. Pushteti serb ia organizoi dy atentate. Në atentatin e parë më 11 mars 1927 u plagos rëndë, por shpëtoi. U vra në atentatin e dytë, që iu bë më 7 maj 1928 në Prishtinë. (Zijadin Gashi)

GAGICA Hafiz (1959-). Veprimtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Gjermani. Lindi në Desivojcë të Gjilanit. Që herët u përfshi në veprimtari politike ilegale. Më 1981 pushteti i atëhershëm lëshoi një urdhër arrest kundër tij. Në janar të vitit 1982 arratiset në Gjermani, ku vazhdoi aktivitetin politik në radhët e mërgimtarëve nga Kosova. Në vitin 1990 u zgjodh kryetar i degës së LDK-së në Gjermani dhe zhvilloi aktivitet të dendur në themelimin e degëve të kësaj partie në shtetet e Perëndimit. Në vitin 1991 u zgjodh kryetar i kolegjiut të degëve të LDK-së në Europë, SHBA, Kanada dhe Australi dhe më pas hapi dhe drejtoi zyrën e Kosovës në Shtutgart. Për shumë vite me radhë kjo zyre u bë lidhja kryesore e Kosovës me Gjermaninë dhe vendet e tjera të Europës. Gjatë viteve '90 H. Gagica inicoi dhe udhëhoqi një sërë protestash masive për liri dhe pavarësinë e Kosovës në shumë shtete të Perëndimit. Jeton dhe vazhdon veprimtarinë në Gjermani. (Fitim Rifati)

GAJTANI Adem (1935-1982). Poet, gazetar, përkthyes. Lindi në Podujevë. Kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në Prishtinë (1955). Nisi studimet për drejtësi në Beograd, i vazhdoi në Shkup. U diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkupit më 1961. Një kohë ishte korrespondent i gazetës “Rilindja” nga Shkupi, më vonë redaktor i rubrikës së kulturës së gazetës “Flaka e vllaznimit” ku e gjeti dhe vdekja e hershme, në vitin 1982. Nga viti 1973 ishte anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë. Ka filluar të shkruajë që nga viti 1952. Poezitë e para i botoi te “Zani i rinisë”, “Jeta e re” dhe te “Rilindja”. Ka shkruar poezi për fëmijë, poezi për të rritur, tregime, drama poetike dhe ka përkthyer nga maqedonishtja në shqip dhe nga shqipja në maqedonisht. Ka botuar librat me poezi: “Drita në zemër” (1961), “Dielli i mbrëmjes, dielli i mëngjezit” (dramë poetike, 1962), “Dryni i heshtjeve” (1964), “Ti kangë, ti zog i largët” (1968), “Unaza”, (1974), “Në ëndërr kënga” (1975), “Amfora e fundosur”, (1977), “Kuq”, (1978), “Kënga e mjellmës” (1980); librat me poezi për fëmijë “Goca e detit” (1966), “Lule më lule”,



ADEM GAJTANI

(1972), “Gejzeri i blertë”, (1982) si dhe librin me tregime “Malbrezet”, (1982). Në vitin 1986 “Flaka e vëllazërimit” nga Shkupi botoi veprën e plotë të A. Gajanit në tri vëllime, përgatitur nga Xhevat Gega. Vjershat e tij u përkthyen në gjuhët e ish-Jugosllavisë dhe u përfshinë në shumë antologji e panorama poetike. Libra të veçantë të poezisë së tij janë botuar në Krushevc, në Sarajevë e Lubjanë, ndërsa katër vëllime me poezi për të rritur dhe për fëmijë janë përkthyer në maqedonisht dhe janë botuar në Shkup. A. Gajtani gjatë gjithë karrierës së tij është marrë dhe me përkthime nga gjuhët sllave në shqip, nga shqipja në maqedonisht. Janë dhjetëra botime të tij të përkthyer, të komentuar dhe të botuara në Shkup dhe Prishtinë. A. Gajtani konsiderohet një nga lirikët më të ndjeshëm të filleve të poezisë sonë të pas Luftës së Dytë Botërore. (Ali Aliu)

GALABRËT. Njëri ndër katër fiset kryesore dardane, i cili banonte në pjesën perëndimore të Dardanisë. Bashkë me dardanët, daunët dhe thunatët krijuan territor kompakt me emrin Dardania. Një pjesë e galabrëve migroi në Italinë Jugore (kapërcyelli i mijëvjeçarit II-I p.e.r.), bashkë me daunët dhe thunatët. Mendohet se sipas galabrëve e mori emrin Kalabria e sotme. Gjatë shek. IV-I p.e.r. Dardania u zhvillua si një shtet i fuqishëm në Ballkanin Qendror. (Emine Kalaja-Hajdari)

GALERITË. Hapësira ekspozuese, të përshatshme për prezantimin e veprave të arteve figurative, ose institucione që merren me këtë veprimtari. Në Kosovë, deri në vitin 1979 ka



NGA NJË EKSPOZITË NË GALERINË E ARTEVE TË KOSOVËS

lunguar institucioni i galerisë së arteve, prandaj disa hapësira të lira në disa institucione kanë

luajtur rolin e galerive të vogla ekspozuese, siç ishte Foajeu i Teatrit Popullor të Prishtinës, Muzeu i Kosovës, Galeria e Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe shtëpitë e kulturës në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe në qytetet e tjera të Kosovës. Këto hapësira ishin të improvizuara dhe pa kuadër profesional, që të merrej me punë artistike. Me rritjen e numrit të artistëve që merreshin me arte figurative, u rritën dhe kërkesat për prezantimin e veprave artistike para auditorit dhe u ndie nevoja për një institucion të mirëfilltë. Kështu, në Prishtinë, në vitin 1979 u themelua Galeria e Arteve e Kosovës. Hapja e këtij institucion të rëndësishëm të veçantë u inicua nga shumë artistë figurativë dhe aplikativë, ndër të cilët u shqua Shyqri Nimanin, drejtor i parë dhe konsolidues i këtij institucioni. Galeria e Arteve e Kosovës në vazhdimësi ka promovuar, ka mbledhur dhe ka ruajtur vlerat artistike të arteve pamore. Gjatë veprimtarisë së saj qoftë para lufte apo pas saj (1999), janë hapur shumë ekspozita individuale dhe kolektive, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Në fondin e Galerisë së Arteve të Kosovës ka rreth 1,000 vepra të gjinive të ndryshme. Me masat e dhunshme që aplikoi Serbia në institucionet e Kosovës më 1990, fushëveprimi i krijuesve dhe i Galerisë u reduktua ndjeshëm. Asokohe mungesën e institucionit përkatës për organizimin e ekspozitave dhe të aktiviteteve të tjera artistike e plotësuan disa galeri të vogla private, si “Dodona”, “Koha” dhe “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë, Galeria “Rada” në Prizren (1995-1998), “Europa” në Pejë (1993-1997), “Vizioni 2000” në Gjakovë një numër kafe-galerish në Prishtinë dhe qytetet e tjera të Kosovës. Pas luftës, krahas aktivizimit dhe riorganizimit të Galerisë Kombëtare të Arteve të Kosovës, në vitin 2000 u themelua Galeria e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë, e cila ka ofruar hapësirë për ekspozita të krijuesve të rinj, ose për trende bashkëkohore figurative. Të dy këto galeri kanë organizuar shumë ekspozita të artistëve vendorë dhe të huaj. Galeria e Arteve e Kosovës aktualisht është institucioni kryesor në fushën e arteve figurative dhe bartëse e të gjitha manifestimeve më të rëndësishme në fushën e arteve pamore. Me karakter ekspozues janë edhe dy galeri private në Prishtinë: Galeria “EXpoart ‘40”, që vepron nga viti 2008 dhe Galeria “Qahili”, e cila vepron nga viti 2013. Edhe në këto dy galeri zhvillohet aktivitet figurativ brenda kornizave profesionale. (Rexhep Goçi)

GALICA Shotë (1895-1927). Luftëtare e çetave kaçake, e shoqja e Azem Galicës. Njihet edhe si Qerime Radisheva. Lindi në Radishevë të Drenicës. Shota u martua me



SHOTË GALICA


udhëheqësin e çetave kaçake, Azem Galicën, në vitin 1915. Luftoi 12 vjet krah për krah me të shoqin për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serbë. Mori pjesë në më shumë se 40 aksione luftarake. Bëri atentat ndaj një oficeri serb

në qendër të Mitrovicës. Më 1919 mori pjesë në kryengritjen e Rrafshit të Dukagjinit, ndërsa në vitet 1922-1923 luftoi për mbrojtjen e Zonës Neutrale të Junikut, e cila shërbente si bazë për kryengritësit e Kosovës dhe të Malësisë. Në korrik të vitit 1924 mori pjesë në mbrojtjen e zonës së lirë të Drenicës. Po atë vit, pas vrasjes së të shoqit Azem Galicës, u vu në krye të çetës dhe vazhdoi luftimet kundër forcave serbe. Së bashku me qindra luftëtarë të Kosovës, në dhjetor të 1924 luftoi kundër ushtrive intervencioniste serbe e bjellogardiste. Në fund të dimrit të vitit 1926 u largua nga Kosova për në Shqipëri, ku u vendos në katundin Shullaz të Krujës. Vdiq në moshë të re, në mjerim të thellë. Pas Luftës së Dytë Botërore shteti shqiptar e shpalli Heroinë të Popullit. (Frashër Demaj).

GALICA Shyqri (1951-). Shkrimtar, profesor universiteti. Lindi në Rashincë të Shtimes. Kreu shkollën fillore në Muzeqinë, ndërsa gjimnazin në Ferizaj. Studioi në Universitetin e Prishtinës, në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Tezën e disertacionit për Faik Konicën si kritik letrar dhe eseist e mbrojti në Universitetin e Tiranës. Punoi një kohë të gjatë në Radio Prishtinë dhe në gazetën “Rilindja”. Më pas u angazhua në procesin mësimor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Botoi veprat: “Koha flet me brezni” (1979), “Poezia e Fatos Arapit” (1990), “Simbolika e sundimit” (1995), “Konica, moderniteti, estetika” (1997), “Identiteti artistik” (2005), “Bota magjike e fëmijës”, (2007) “Mesazhi intelektual” (2012) etj. Në fillim shkroi poezi, më pastaj u mor me kritikë letrare dhe studime. (Kujtim Rrahmani)

GALLAPIT (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Është më konservative se të folmet e tjera. Njeh tri seri zanoresh të theksuara: zanore gojore të shkurtra, zanore gojore të mesme dhe zanore gojore të gjata, si dhe pesë zanore hundore. Zanorja *e* nuk hyn në raporte kundërvënëse, ndërkohë që zanorja *o* nuk del e nazalizuar. Kundërvënie fonologjike formojnë zanoret e shkurtra e të gjata dhe zanoret gojore me hundoret. Hundorëzimi i zanoreve është tipar i theksuar i kësaj të folmeje. Zanorja *o* realizohet në dy variante: si *o* e ngritjes së mesme, e hapur dhe shumë e labializuar dhe si *ö* e mbyllur, më shumë e labializuar, që zakonisht del e gjatë ose e mesme. Diftongu *ue* ka dhënë dy reflekse: në pozicionin fundor, në rrokje të hapur, është shndërruar në grup zanor me theks në elementin e parë (*krúe, rrxúe*), ndërsa në rrokje fundore të mbyllur ruhet si diftong. Diftongu *ie* është ruajtur në këtë të folme, por ka edhe raste të evoluimit të tij në grup zanor. Mesgjuhoret okluzive *q, gj* kanë kaluar në afrikate *ç* dhe *xh*, ndërsa si fonemë më vete del *η*-ja, që është rezultat i asimilimit të grupit *ng*. Kjo fonemë i kundërvihet fonemës *n* paragjuhore: *kân:kân* (*këngë-këná*). Bashkëtingëllorja *nj* ruhet vetëm në pozicionin nistor, ndërsa në të gjitha pozitat e tjera alternohet në *j*. Vibrantet *r-R* krijojnë opozicion fonologjik. Grupet e vjetra konsonantike *kl* dhe *gl*, pastaj *mb, nd, ng* dhe *ngj* janë asimiluar në elementin e parë të tyre, ndërsa grupet *tj* dhe *dj* ruhen mirë. Në raste të caktuara, posaçërisht te numërorët, ndeshet dukuria e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme (*pesthët, gjashtthët*). Në këtë të folme përdoren emrat e nyjzuar: *i tupallsi, i gollaksi*, ndërkohë që del përemri vetvetor *përveti* dhe trajtat e dëftorëve: *çyky, çasish, çisi*. Përcjellorja ndërtohet me pjesëzat *túe, túi, týe, tý*, ndërsa në sistemin foljor kohët e mbipërbëra kanë përdorim të dendur. Gallapi shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Kosovës dhe në një pjesë të Republikës së Serbisë. Gjithë territori i kësaj krahine administrohet nga komunat e Prishtinës, Podujevës, Novobërdës, Kamenicës, Vranjës dhe Medvegjës. (Haki Hysenaj)

GAMI Malo (1914-1997). Aktor. Lindi në Gjirokastrë. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) u angazhua nga viti 1951. Pati një karrierë të pasur teatrore, për më se 40 vjet, kryesisht në skenën e TPK-së, duke u shquar si



MALO GAMI

aktor me vokacion komik. Ndër rolet e tij në teatër veçohen ato në shfaqjet: “Fjala është për banesë” (1954), “Shërbëtori i dy zotnive” (1955), “Koshtana” (1955), “Kushëriri prej Amerikës” (1956). Disa nga shfaqjet e tjera

të TPK-së, në të cilat interpretoi janë: “Zullumqari”, “Tri botëna”, “Nuk marrohem me parë”, “Nita”, “Halit Gashi”, “Koshtana”, “Kryet e hudrës”, “Zonja ministreshë”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Miu në xhep”, “Banesa e përbashkët”, “Pjata e drunjte”, “Autobiografia”, “Rrathët”, “Fosilet”, “Halili dhe Hajria”, “Mbreti Edip”, “Besa e madhe”, “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”, “Dervishi dhe vdekja”, “Emira” etj. Për kreacione artistike u vlerësua me çmime dhe mirënjohje. Vdiq në Zagreb. (Arian Krasniqi)

GANGALE Xhuzepe Tomas (Guiseppe Thomas 1898-1978). Gjuhëtar, teolog, filozof dhe shkrimtar italian. Lindi në Ciro Marina të Italisë. Arsimin e mesëm e përfundoi në kolegjin në Shën Mitër. Studioi në Firencë, ku u diplomua me tezën “Mbi mendimet e Paskalit”. Si mik i Piero Gobetit, drejtoi revistën javore “Conscientia”, ndërmjet viteve 1924-1929, në të cilën zhvilloi debat mbi fazhizmin dhe katolicizmin. Qe themelues dhe drejtor i Qendrës gjuhësore greqisht-shqip (Crotone). Shkroi shumë vepra, ndër to edhe “Fragmente etnologjike arbëreshe të Kalabrisë së mesme” (1979). Njihet për fondin Gangale me dorëshkrime e botime arbëreshe në Bibliotekën Mbretërore të Danimarkës. (Mensur Vokri)

GARASHANIN (Garašanin) Ilija (1812-1874). Politikan dhe burrështetas serb. Ishte personalitet me ndikim në jetën politike serbe gjatë sundimit të Dinastisë së Karagjorgjeviqëve (1842-1858). Një kohë ishte ministër i Punëve të Brendshme dhe pati ndikim vendimtar në formimin dhe konsolidimin e kësaj ministrie. Garashanin ka qenë edhe ministër i Punëve të Jashtme të Principatës Serbe. Në vazhdimësi u angazhua për zvogëlimin e ndikimit të Fuqive të Mëdha të asaj kohe në jetën politike të kësaj principate. Është hartues i projektit “Naçertanija” (Projekti) më 1844, sipas të cilit Serbia duhej të angazhohej dhe të punonte për

çlirimin e të gjithë sllavëve të jugut, qoftë nga Austro-Hungaria, apo nga Perandoria Osmane dhe, në këtë mënyrë, të përtërihej perandoria mesjetare e mbretit Dushan. Projekti i hartuar nga Garashanin cenonte rëndë interesat e popullit shqiptar. Sipas këtij projekti, Serbia do të shtrihej në Shqipëri deri te lumi Shkumbin, duke përfshirë Kosovën e sotme dhe viset shqiptare të Maqedonisë. Nga kjo kohë këto territore të pretenduara nga Principata Serbe filluan të quheshin “Serbi e vjetër”. (Isa Bicaj)

GARASHANIN (Garašanin) Milutin (1920-2002). Arkeolog serb, akademik. Punoi në Muzeun e Beogradit, në Muzeun Popullor të Serbisë, në Institutin Arkeologjik të Serbisë dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, ku ligjëroi arkeologjinë parahistorike. Ishte anëtar i disa instituteve dhe asociacioneve europiane për studime historike, parahistorike dhe protohistorike. Shkroi një numër të madh punimesh shkencore dhe është autor dhe bashkautor i disa librave dhe monografive. Preokupim kryesor kishte epokën parahistorike (kultura e Vinçës, kultura Bubanj-Hum, kultura e Dobraqës, kultura e Paraqinit, kultura e Medianës). Gjurmioi tumat e epokës së bronzit në Ujëz te Ura e Fshejtë (Gjakovë) dhe shkroi thujse për të gjitha periudhat parahistorike të Kosovës. Ndonëse gjatë karrierës ishte mbështetës i përkatësisë ilire të dardanëve, pas vitit 1981 ndryshoi qëndrim, si pasojë e ndikimeve politike dhe përkrahu tezën dako-meze të prejardhjes së dardanëve. (Haxhi Mehmetaj)

GASHI Abdurrahim (1922-). Pedagog, veprimtar i arsimit. Lindi në Uçë të Istogut, shkollën fillore e kreu në vendlindje, progjimmnazin në Shkup, shkollën normale në Prishtinë dhe në Gjakovë. Studio pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Shkupit, ku diplomoi në vitin 1961. Me veprimtari arsimore u mor aktivisht nga vitit 1942 deri në vitin 1982. Filloi si mësues në vendlindje, për të vazhduar si inspektor arsimit, ndërsa ishte drejtor i gjimnazit në Istog për 19 vjet radhazi. Ishte anëtar i Pleqësisë së Arsimit të rrethit të Pejës, anëtar i Pleqësisë Krahinore të Arsimit etj. A. Gashi u mor edhe me përkthimin e teksteve me karakter pedagogjik. Botoi një sërë punimesh profesionale nga fusha e arsimit, si dhe veprën autobiografike “Një jetë me shkollën” (2015). (Demë Mulliqi)

GASHI Adem (1953). Poet, prozator, eseist. Lindi në Nekoc të Drenasit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje dhe në Komoran, ndërsa Shkollën Normale dhe studimet për letërsi shqipe në



ADEM GASHI

Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Punoi si arsimtar e mëpastaj gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës (1977). Nisi studimet pasuniversitare, të cilat i ndërpreu pas burgosjes në vitin 1982. Mbas daljes nga burgu vijoi punën e gazetarit dhe eseistit në revistën "Ora" në Prishtinë (1996), pastaj u emërua drejtor i programit satelitor të Televizionit Shqiptar në Tiranë (1996-1999), programi për Kosovën. Në vitin 1999 u emërua drejtor i Radiotelevizionit të Kosovës si dhe u zgjodh nënkryetar e mëpastaj edhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Nga viti 2002 e prapa kreu funksione të ndryshme në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. Botoi veprat poetike: "Pa ombrellë" (1982), "Duke punuar autoportretin" (1985), "Realiteti objektiv" (1990), "Ëndrra të liga" (1995), "Dorëshkrim i djegur" (2000), "Lulet e vetmuara" (2001), "Lady Mak(th)beth" (2006), "Kthimi i pamundur, Lady" (2013), "Labirinthet e makthit" (2015). Nga proza e shkurtër botoi: "Vdekja e mixhës" (1987), "Pëllumbi i paqes" (1989), "Udhëtimi i fundit" (2002) për të vijuar me romanet "A... ZH- Vetëtimat e nëntorit" (2005) dhe "Dita tjetër e jetës" (2014). Disa nga veprat e tij janë shpërblyer me çmimet kryesore nacionale si dhe janë përkthyer në gjuhë të huaja. Shprehjen artistike të Gashit e shquante lirizmi, i cili rrjedh nga paradokset e jetës individuale e shoqërore, duke vijuar me veprat e mëvonshme, ku dominon sinkretizimi i formave të shprehjes artistike. (Nysret Krasniqi)

GASHI Y. Agron (1977-). Shkrimtar. Lindi në Papiq të Deçanit. Në vitin 2002 përfundoi studimet në Fakultetin e Filologjisë, dega e letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës (UP). Po aty ndoqi studimet pasuniversitare. U doktorua në letërsi shqipe në vitin 2016. Njëkohësisht ka përfunduar studimet për shkenca politike në Fakultetin Filozofik dhe është specializuar për çështje të sigurisë kombëtare në Universitetin Amerikan të

Kosovës. Në vitin 2007 ka drejtuar revistën e përmuajshme për art, letërsi dhe kulturë "ProCult". Është mësimdhënës në shkollën jopublike "Mileniumi i tretë" dhe mësimdhënës bashkëpunëtor në Fakultetin e Filologjisë të UP-së për lëndët shkrim kreativ dhe akademik, semiotikë, stilistikë e gjuhës, analizë diskursi. Ka botuar këto libra: "Autopoetika - Modelet narrative autobiografike" (studim, 2009), "Mizanteksti - Poetika, sisteme, autorë, vepra" (studim, 2012), "Talianka - Intermexo nga jeta e një heroji" (roman, 2012), "Rrëfimet e maestros - Dialog me avangardistin e viteve '70, Musa Ramadanin" (2014). Është kryeredaktor i revistës letrare "Jeta e re". (Zejnullah Rrahmani)

GASHI Ahmet (1888-1977). Veprimtar i lëvizjes kombëtare dhe i arsimit, gjeograf e historian, Mësues i Popullit. Lindi në Prishtinë, ku mori mësimet e para. U diplomua për histori dhe gjeografi në Universitetin e Stambollit (1910). Dha mësim në gjimnazin e Prishtinës dhe mori pjesë në kryengritjen shqiptare për liri e pavarësi të viteve 1910-1912. Që me ngritjen e departamentit të arsimit në Qeverinë



AHMET GASHI

e Përkohshme të Vlorës u emërua profesor në Normalen e Elbasanit, ku qe edhe drejtor në vitet 1927-1933. Mori pjesë si delegat në kongreset arsimore të viteve 1920 e 1922, ndërsa në Kongresin Arsimor të Tiranës (1924) u zgjodh kryetar i tij. Dha mësim edhe në Institutin Femëror "Nana Mbretreshë" në Tiranë (1933-1941) dhe ishte drejtoi gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë (1944). Në vitet 1945-1964 punoi mësues i gjeografisë në Tiranë. Njihet si autor i një vargu veprash shkollore në fushën e gjeografisë. Ka botuar tekstin "Gjeografia e Shqipërisë" për shkollat e mesme (1933, ribotuar më 1937 nën titullin "Shqipnia") dhe "Gjeografia e përgjithshme" për shkollat e mesme (1935). Përpiloi dhe botoi disa harta gjeografike e historike, ndër to edhe hartën e përmasave 1:550.000 "Shqipnia e vërtetë" (1941). Është i pari gjeograf shqiptar i pranuar si anëtar i Shoqatës Gjeografike Amerikane (The National Geographic Society, Washington D.C.) më 1936. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Mevlan Kabo)

GASHI Ali (1951-2018). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku e kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin



ALI GASHI

teknik (FT) të Universitetit të Prishtinës (UP) (1976). Përfundoi studimet e magjistraturës në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin Elektroteknik të UP-së (1994). Më 1976 u zgjodh asistent në FT të UP-së dhe më pas merr titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor i rregullt (2005) për lëndët mbrojtja rele, sistemet matëse në elektroenergjetikë, matjet elektrike etj. Kreu detyra udhëheqëse në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Puna e tij profesionale shtrihet në zgjidhjen e problemeve teknike në termocentralet e Kosovës, në Hidrocentralin e Gazivodës, në stacionet dhe nënstacionet elektrike. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore të prezentuara në vend dhe jashtë. Është autor i dispensave universitare dhe bashkautor i teksteve për shkollat e mesme elektroteknike. (Isuf Krasniqi).

GASHI Alush (1950-). Mjek, anatomist, mësimdhënës universitar, politikan. Lindi në Prigodë të Istogut, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, Fakultetin e Mjekësisë



ALUSH GASHI

në Prishtinë (1974). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Zagreb (1977), tezën e doktoratës e mbrojti po në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit (1979). Ish-te doktori i parë i shkencave të anatomisë në Kosovë dhe doktori më i ri i shkencave mjekësore të kësaj fushe në ish-Jugosllavi. Gjatë studimeve u zgjodh demonstrues në Institutin e Histologjisë dhe të Embriologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë e më pas asistent i lëndës së anatomisë. Specializimin e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe në Kaliforni. Mbaroi specializimin për kirurgji të përgjithshme. Ishte drejtor i Institutit të Anatomisë në

Prishtinë, më pas dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë (1989-1991). Ka botuar një sërë punimesh shkencore dhe një tekst universitar. Që në vitet '90 u përfshi në aktivitete politike, së pari në Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtat të Njeriut (KMLDNJ), pastaj në Lidhjen Demokratike të Kosovës. Pas vitit 1999 dy mandate ishte deputet i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i grupit parlamentar të LDK-së. Më pas, në qeverinë e koalicionit me Partinë Demokratike të Kosovës u emërua ministër i Shëndetësisë. (Ismajl Dreshaj)

GASHI Antonio (1966-). Violonçelist, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. Studimet i filloi në Akademinë e Muzikës në Novi-Sad (prof.



ANTONIO GASHI

Varga), i vazhdoi në Zagreb, ku u diplomua më 1991 (prof. V. Deshpali). Studimet pasuniversitare dhe specializimin për muzikë kamerale i kreu më 1992 në "Hochschule für Musik", Detmold, Gjermani (prof. K. Gergian e M. Carniero). Ishte anëtar i Orkestrës së Zagrebit, "Jeunesses Musical World Orchestra", udhëheqës i violonçelistëve në "Detmolder Kamerorchester", i Orkestrës së Radiotelevizionit të Prishtinës. Është anëtar i Filarmonisë së Kosovës dhe udhëheqës i violonçelistëve. Ka koncertuar si solist dhe anëtar i ansambleve dhe formacioneve të ndryshme orkestrale në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Itali, Austri, Zvicër, Gjermani, Francë, Spanjë dhe shumë vende të tjera të botës. Ka interpretuar vepra autorësh shqiptarë dhe të huaj, midis të cilave: Edward Elgar, Koncerti për violonçel e orkestër, e-mol op.75; Antonin Dvorzhak, Koncert për violonçel e orkestër, b-mol op.104; Sergej Rahmaninov, Sonatë për violonçel e piano; Rexho Mulliqi, Elegjia për violonçel e piano etj. Është profesor i violonçelit dhe i muzikës kamerale në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Kristina Palokaj-Përkola)

GASHI Astrit (1977-). Gazetar. Lindi në Mitrovicë. Kreu studimet dhe u kualifikua për gazetari nga Instituti KIJAC në Prishtinë. Me gazetari filloi të merret qysh në kohën e luftës në Kosovë (1998/99). I takon gjeneratës së parë

të gazetareve të gazetës së përditshme “Koha ditore”, që raportuan për zhvillimet dramatike në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999 hulumtoi dhe shkroi kryesisht për temat ekonomike, për ristrukturimin e ndërmarrjeve dhe për aferat e korrupsionit në institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Në cilësinë e redaktorit udhëhoqi shtojcën për ekonomi në gazetën “Koha ditore”. Më pas ishte bashkëthemelues i gazetës “Lajm”, pastaj i gazetës “Express”, për të kaluar pastaj në sektorët e komunikimit medial të marrëdhënies me publikun të Postës dhe Telekomit të Kosovës dhe operatorit të telefonisë mobile “Vala”, si dhe të operatorit privat IPKO. Në vitin 2009 ishte kryeredaktor i gazetës “Zëri”. Në vitin 2014 ishte njëri nga themeluesit e portalit “Gazeta Blic”. (Artan Krasniqi)

GASHI Atdhe (1941-). Regjisor, dramaturg. Lindi në Tiranë. Përfundoi studimet për regji në Akademinë për Teatër Film dhe Televizion në Lubjanë. Është autor i shumë realizimeve



ATDHE GASHI

skenike në Teatrot e Prishtinës, të Shkupit, Gjilanit, Prizrenit, Gjakovës etj. Në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) gjatë viteve ‘70 realizoi shfaqjet: “Dasma e përgjakur” (1972) të F. G. Lorkës, pastaj me trupën serbe të TPK-së në vitin 1974 realizoi shfaqjen “Margareta” të A. Salekut dhe më pas shfaqjet: “Njeriu që pa vdekjen me sy” (1974) të V. Eftiumiut, “Mosha e bardhë” (1974) të D. Agollit, “Deklarata” (1977) të K. Klariqit, “Besa e madhe” (1978) të M. Markajt etj. Është autor i dramave “Lindjet e vështira”, “Martesa”, “Gafi”, “Pse”, “Ferra e nisi, ferra e grisi”. Përveç në fushën e regjisorës në teatër dhe të shkrimit të dramës, u angazhua edhe në film dhe televizion. Është skenarist i filmit artistik “Pikniku” me regjisor E. Halilin, prodhuar nga “Kosovafilmi” në vitin 1986. (Arian Krasniqi)

GASHI Azem (1945-). Piktur. Lindi në Çabiq të Klinës. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në Klinë, studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1977). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1977. Hapi ekspozita vetjake më 1983 në Prishtinë, më 1995 në Prizren dhe më 1998 në Ulqin. Si anëtar i SHAFK-ut mori

pjesë në ekspozitat e përbashkëta nga viti 1980 në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë, në Sallonin Pranveror (1981-1987), në Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit (1987) dhe në Shkup (1987). Për nga vokacioni i takon drejtimit ekspresionist, duke trajtuar figurën e njeriut me të gjitha ankthet dhe dramën e tij shpirtërore. Është nga krijuesit të cilit ushtria dhe policia serbe ia dogjën pothuaj tërë krijimtarinë artistike. Më 1987 fitoi Çmimin e Bienales së Vizatimit në Prishtinë. (Tahir Emra)

GASHI Bajram (1909-1945). Ushtarak, mësues, organizator i qëndresës së armatosur pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Uçë të Istogut. Familja e tij u shpërngul në Shënavlash të Durrësit. Pas shkollimit të mesëm, mbaroi Akademinë Ushtarake në Romë. Në vitet 1938-1941, punoi si mësues, e më pas edhe drejtor i shkollës në Shënavlash. Më 1941 u kthye në Kosovë, ku emërohet federal i prefekturës në Pejë. U shqua për angazhimin e tij në kuadër të forcave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe organizoi formacionet ushtarake vullnetare në mbrojtje të viseve kufitare, veçmas në zonën e Podgurit, kundër forcave çetnike e partizane jugosllave. Pas përfundimit të luftës, së bashku me një grup luftëtarësh të Gashit organizoi qëndresën e armatosur (1944-1945). U vra më 7 maj 1945, bashkë me tre bashkëluftëtarë, pas rrethimit të një batalioni të Brigadës IV të Kosovës në bjeshkët e Rakoshit. Pas vrasjes, trupat e tyre u ekspozuan në qendër të Istogut. (Muhamet Shatri)

GASHI Bardh Isuf (1875-1945). Luftëtar i lëvizjes kaçake, që luftoi për çlirimin e Kosovës nga viti 1912 e deri më 1945. Ishte pjesëmarrës i ngjarjeve të rëndësishme: i Lidhjes së Pejës (1899), i Kuvendit II të Verrat e Llukës (1910), i kryengritjes përgjithshme shqiptare të vitit 1912, i Kuvendit të Junikut (1912) dhe i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1918-1924). Gjatë viteve 1921-1923, bashkë me më se 2,000 luftëtarë të armatosur qëndroi në Zonën Neutrale të Junikut, kurse pas pushtimi të saj nga Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene vazhdoi qëndresën e armatosur kundër pushtuesit dhe bandave çetnike. Pas rënies së Mbretërisë së Jugosllavisë dhe bashkimit të Kosovës me Shqipërinë më 1941 u rikthye në vendlindje dhe u zgjodh kryetar i Këshillit për Pajtimin e

Gjaqeve për nënprefekturën e Istogut (1941-1944). Pas vendosjes së pushtetit komunist, me bashkëluftëtarët e tij doli në mal, për të vazhduar qëndresën kundër pushtetit jugosllav. Më 20 prill 1945 u rrethua në vendstrehimin e tij të Bjeshkës së Thatë mbi fshatin Kaliçan të Istogut, ku u vra nga partizanët malazezë. (Isa Bicaj)

GASHI Bedrush (1964-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Drenoc të Rahovecit. Pasi kreu shkollën e mesme në Rahovec, u regjistrua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Ishte aktiv në ndërtimin e sistemit për financimin e arsimit shqip gjatë viteve '90. Që në fillimet e luftës ishte pjesëtar i UÇK-së dhe mori pjesë në aksionet e para të saj kundër forcave serbe në Anadrini. Në natën e 11-12 shtatorit 1997, së bashku me M. Zymberajn dhe shokë të tjerë sulmuan stacionin e policisë serbe në Ratkoc të Rahovecit. Më 3 qershor 1998, kur në Drenoc u themelua formacioni i parë ushtarak, mori detyrën e ndihmëskomandantit për logjistikë. Gjatë gjithë kohës së luftës, kreu detyra me përgjegjësi në fushën e logjistikës. U vra gjatë luftimeve me forcat serbe më 12 maj 1999. U dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Bedri Zyberaj)

GASHI Besim (1974-). Skulptor. Lindi në Pejë. Mbaroi shkollimin fillor dhe Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Kreu studimet për skulpturë në Akademinë e Arteve Figurative në Prishtinë (1997). Në vitet 2000-2009 ka punuar si skenograf në "Kohavision" (KTV) dhe ka dhënë mësim në Shkollën e Mesme të Arteve Aplikative në Pejë. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) dhe ka marrë pjesë në disa aktivitete të saj. Ndër ekspozitat personale veçohen: Galeria "Evergrin" në Pejë më 1996, Galeria "Rada" në Prizren më 1997, pastaj në Prishtinë (2003), në Tiranë (2006) etj. Ka marrë pjesë edhe në disa ekspozita të përbashkëta të organizuara nga SHAFK-u. Është realizues i portreteve në bronz të dëshmorëve të kombit (2003), ndërsa nga realizimet më të suksesshme shquhen kompozimet e cikleve "Tapirët", "Fokat" dhe portretet e personaliteteve historike. Ka fituar disa çmime, si çmimin e dytë "Krerët simbolikë" në Prizren (1997), përvjetori i çmimit "Nënë Tereza" dhe çmimin e Sallonit të Nëntorit në Prishtinë (2006). (Agim Rudi)

GASHI Brahim Sefë (1918-1975). Rapsod popullor, i njohur edhe me emrin Sefë Mleqani. Lindi në fshatin Mleqan të Malishevës. Ishte njëri ndër rapsodët më të njohur në trashëgiminë etnomuzikore shqiptare në Kosovë. U bë i njohur për këngët kreshnike të përcjellë me lahutë dhe ato historike, me sharki. Shumë këngë të kënduar prej tij kanë hyrë në përmbledhjet "Këngë kreshnikë II" të Institutit Albanologjik të Prishtinës. S. Mleqani ua ka lënë këndimin trashëgim edhe djemve të tij, që njihen si këngëtarë: Bijtë e Sefë Mleqanit. Në përvjetorët e vdekjes së tij shpesh organizohen tubime të rapsodëve, në kujtim të jetës e veprës së tij. (Visar Munishi)

GASHI Burim (1973-). Skulptor. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ku kreu edhe Akademinë e Arteve, drejtimin e skulpturës, (1998). Nga viti 2011 u angazhua si mësimdhënës në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Është pjesëmarrës i një sërë ekspozitash kolektive, si: "Expo-diaspora", Boholt, Gjermani (2013); "Portrete", koleksioni i Galerisë në Prishtinë (2015); "Rest Art", edicioni VII, Tiranë (2015); "Çmimi Muslim Mulliqi" (2003, 2004); Salloni i Nëntorit (2002, 2003, 2004); ekspozita "Arti modern i Kosovës" në Galerinë e Artit Modern në Bombaj, Indi (2004) etj. Është fitues i çmimit të parë në Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit (2004) dhe çmimit të parë në ekspozitën "Portreti" (2002). (Luan Mulliqi)

GASHI Emine (1940-). Mjeke, gjinekologe, mësimdhënëse universitare. Lindi në Prizren, arsimimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë (1963). Pas diplomimit u emërua mjeke në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren. Specializimin nga gjinekologjia dhe obstetrika e filloi në Prizren dhe Gjilan, kurse e mbaroi në Beograd. Deri në vitin 1971 punoi në repartin e gjinekologjisë në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, kur u zgjodh asistente e lëndës gjinekologji me obstetrikë në Fakultetin e Mjekësisë dhe nisi punën në Klinikën Obstetrike-Gjinekologjike në Prishtinë. Në vitin



EMINE GASHI

1974 u emërua kryeshefe e repartit të obstetrikës të kësaj klinike, ku punoi deri në gusht të vitit 2000. Mbrojti tezën e doktoratës në vitin 1979 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa gjatë viteve 1983-1984 qëndroi në Karolinën e Veriut në SHBA për përsosje profesionale. Pas luftës, më 1999, u kthye në Klinikën Obstetrike-Gjinekologjike në Prishtinë dhe vazhdoi punën si kryeshefe e repartit deri në vitin 2000, kur në moshën 60-vjeçare u dërgua në pension pa pëlqimin e saj. Mori pjesë në disa kongrese dhe simpoziume, si dhe publikoi një numër punimesh shkencore, si autore dhe bashkautore. (Isuf Dedushaj)

GASHI Emrush (1939-2011). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në fshatin Mramor të Prishtinës, ku kreu shkollën fillore, të mesmen në Prishtinë dhe degën e matematikë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1964). Studimet pasuniversitare në lëmin e algjebrës i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit. Mbrojti tezën e disertacionit në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1973). Në vitin 1966 zgjidhet asistent në degën e matematikës, pastaj ligjërues, docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar (1983) në FSHMN të Universitetit të Prishtinës. Senati i Universitetit të Prishtinës i dha titullin “Profesor emeritus”. Ligjëroi kurse të ndryshme në studimet themelore e pasuniversitare. Kreu specializimin në Rusi dhe në Moldavi dhe publikoi disa punime shkencore në revista ndërkombëtare e vendore, tekste universitare dhe tekste për shkolla të mesme. Është autor i monografisë “Teoria aditive e idealeve dhe teoria e radikaleve të unazave” (botim i ASHAK-ut). Rezultatet i paraqiti në shumë tubime shkencore. Kreu detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës. (Minir Efendija)

GASHI Feim (1971-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Drenoc të Rahovecit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, ndërsa të mesmen në Rahovec. Derisa ishte nxënës i shkollës së mesme, mori pjesë në demonstratën e 28 marsit të vitit 1989 në Rahovec. Pas mbarimit të shkollës së mesme, u regjistrua në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” në Prizren, pastaj në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të

Prishtinës. Krahas studimeve u angazhua në aktivitete politike të kohës. U bë pjesëtar i UÇK-së në nëntor të vitit 1997. Më 27 maj të vitit 1998 vritet në luftë me forcat serbe. Pas luftës, tema e diplomës, të cilën ai nuk kishte arritur ta mbronte sa ishte gjallë, u publikua në revistën shkencore për sëmundjet dhe mbrotjejn e bimëve (Journal of Plant Diseases and Protection) në Shtutgart të Gjermanisë. (Bedri Zyberaj)

GASHI Fraim (1968-). Kontrabasist. Akademinë e Muzikës e kreu në Lubjanë (1992), ndërsa studimet pasuniversitare për kontrabas në “Conservatoire de Lausanne” të Zvicrës (1999). Ishte kontrabasist në Operën e Lubjanës (1990-1992) dhe në Filarmoninë Sllovene (1992-1996). Gjatë viteve 1996-2006 ishte pjesëtar i orkestrave: Sinfonietta (Lausanne), Orkestra simfonike (Friburg), Filarmonia kamerale e Zvicrës, Orkestra harkore (Yverdon), Orkestra kamerale (Gjenevë). Dha koncerte solistike në Lubjanë (1991) dhe në Lozanë (1998). Mori pjesë në Festivalin e Opatisë (1990), në festivalin “Puccini” në Torre de Lago, Itali (1990, 1991,1992), në festivalin “Avanches” në Zvicër, në Kamerfest (2000) dhe “Re-Musica” në Prishtinë (2005, 2006). Gjatë shkollimit është shpërblyer në gara të instrumentistëve në ish-Jugosllvi. Nga viti 2010 është profesor i lëndës kontrabas në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe udhëheqës i seksionit të kontrabasit në Orkestrën e Filarmonisë së Kosovës. (Indira Çipa)

GASHI Gani (1944-). Grafist. Lindi në Mramor të Prishtinës. Akademinë e Arteve Figurative dhe studimet pasuniversitare, drejtimi i grafikës, i mbaroi në Prishtinë. Punoi shumë vjet si redaktor teknik dhe artistik në gazetën “Rilindja”, deri në mbylljen e saj. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1983 dhe mori pjesë në ekspozitat e saj. Hapi ekspozita personale në Prishtinë (1968, 2007), në Kranj të Sllovenisë (1968), në Zofingen të Zvicrës (1992), Kaufering dhe Augsburg të Gjermanisë (1994, 2008), pastaj në Prizren (1996), Gjilan (2003), Tiranë (2004, 2008) etj. Është fitues i disa çmimeve, si çmimi i parë për pikturë në “Ekspozita pranverore” të SHAFK-ut në Prishtinë (2005), çmimi i parë për pikturë në Sallonin e Nëntorit në Galerinë e Arteve të Kosovës, (2008) etj. Krijimtaria e tij

artistike shquhet për nga paraqitjet e figurave të lashtësisë, me kafka e portrete të distorzuara dhe të përshkuara me kolorit komplementar. (Basri Mekolli)

GASHI Gani (1961-). Arkitekt konservator-restaurues. Lindi në Prizren. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prizren, ndërsa u diplomua në Universitetin e Prishtinës. Filloi punë në Entin për Mbrojtje të Monumenteve të Kulturës në Prishtinë, ku punoi në sektorin e arkitekturës për konservim-restaurim. Aty fitoi gradat dhe titujt profesionalë për konservim-restaurim të arkitekturës. Realizoi me kritere vlerësuese disa projekte në lidhje me restaurimin e ndërtimeve arkitektonike, kryesisht të karakterit fetar dhe civil, objekte të ndërtimitarisë utilitare, të traditës popullore shqiptare etj. Inventarizoi dhe përcaktoi kritere vlerësuese të një numri të ndërtimeve të trashëgimisë të arkitekturës popullore, si dhe hartoi dosje për trashëgiminë e palëvizshme, të monumenteve të arkitekturës banesore, fshatare e qytetare. Udhëhoqi dhe realizoi disa projekte restauruese, kulla në veçanti, si: kullën e Osajve në Isniq të Deçanit, kullën e Gockajve në Pejë, kullën e Avdylve në Dobroshec të Drenasit etj. Realizoi dhe udhëhoqi projektet restauruese të Xhamisë së Bajrakut dhe Çarshisë së vjetër në Pejë, Xhaminë e Çarshisë në Prishtinë, Urën e Terzive në Gjakovë etj. (Fejaz Drançolli)

GASHI Gani (1965-2013). Gjeograf, profesor universiteti. Lindi në Mramor, komuna e Prishtinës. Arsimimin bazë e mori në Prishtinë, ku kreu edhe shkollimin e lartë. U diplomua për gjeografi në Universitetin e Prishtinës (1989). Një vit më vonë punësohet asistent në degën e gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN). I regjistroi studimet pasuniversitare në Zagreb, për t'i përfunduar në Prishtinë, ku mbrojti magjistraturën dhe më pas, në vitin 2006 mbrojti disertacionin e doktoratës nga fusha e hidrologjisë. Një kohë ka punuar mësimdhënës në shkollë të mesme në Prishtinë, ndërsa nga viti 1990 u zgjodh asistent në degën e gjeografisë. Në periudhën 2003-2007 punoi në sektorin e hidrologjisë në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, për t'u rikthyer sërish në departamentin e gjeografisë. (Hivzi Islami)

GASHI Hamdi (1945-1999). Agronom, profesor universiteti. Lindi në fshatin Mramor, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në Mramor, të mesmen bujqësore në Prishtinë, studimet e rregullta dhe pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit (1972). Punoi në Institutin për Hulumtime Bujqësore në Pejë, në Shkollën e Mesme Bujqësore në Lipjan, në kombinatin "Agrokosova" dhe në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Në vitin 1982 largohet nga procesi mësimor për shkaqe politike, por kthehet sërish ligjërues i lëndës së pedologjisë (1992). Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së (1998). Kreu disa funksione në institucionet e arsimit të lartë. Punoi në projekte për hulumtimin e tokave bujqësore. U vra nga forcat ushtarake-policore serbe në maj të vitit 1999. (Xhevdet Elezi)

GASHI Hamdi (1951-). Inxhinier i elektroteknikës. Lindi në fshatin Mramor, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, studimet nga fusha e energjetikës në Fakultetin Elektroteknik të Universitetin e Prishtinës (1977). Punoi si inxhinier përgjegjës në Elektroekonominë e Kosovës, pastaj (1980) u caktua inxhinier kryesor në stabilimentet elektrike 220/110/35 KV. Dha kontribut të çmuar në mirëmbajtjen dhe rikonstruktimin e këtyre stabilimenteve. Në vitin 2000 u emërua drejtor teknik i Termocentralit "Kosova A", ndërsa në vitin 2002 menaxher i këtij termocentrali. Në këtë periudhë janë kryer me sukses riparimet dhe rehabilitimet e turbinave, të gjeneratorëve dhe të kaldajave me avull, si dhe të pajisjeve përcjellëse të blloqeve të Termocentralit "Kosova A", me ç'rast u rrit siguria e furnizimit me energji elektrike e konsumatorëve në Kosovë. Në vitin 2012 u caktua drejtor ekzekutiv i Termocentralit "Kosova A". Gjatë kësaj periudhe janë kryer riparime kapitale të blloqeve dhe të pajisjeve në këtë termocentral. (Isuf Krasniqi).

GASHI Ibrahim (1963-). Historian, profesor universiteti. Lindi në Llapushnik të Drenasit. Shkollën fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Filloi punën si asistent (1994) dhe



IBRAHIM GASHI

më pas ligjërues (1998-2004) në departamentin e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2003 u doktorua në historinë politike të Ballkanit. Nga viti 2004 ligjëroi edhe në departamentin e shkencave politike.

Ligjëron lëndët histori botërore bashkëkohore, hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare dhe politika e Jashtme e diplomacia. Ka ushtruar disa funksione në UP, si anëtar i këshillit drejtues të Universitetit, pastaj zëdhënës dhe në periudhën 2012-2014 rektor i UP-së. Ka ushtruar edhe poste politike dhe ka qenë deputet dhe nënkryetar i Parlamentit të Kosovës (2007-2011) dhe zëvendësministër i Jashtëm (2011-2012). Është nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Është autor i studimeve monografike, i teksteve universitare dhe i disa punimeve shkencore të botuara në revista vendore dhe ndërkombëtare. (Zeqirja Idrizi)

GASHI Imzot Zef (1938-). Titullar i kishës katolike, argjipeshkëv. Lindi në fshatin Peshter, komuna e Lipjanit. Arsimin fillor e mbaroi në vendlindje, ndërsa gjimnazin klasik në Rijekë



IMZOT ZEF GASHI

të Kroacisë. Kreu studimet për filozofi dhe teologji në Lubjanë e Zagreb (1970). Ishte famullitar i Prishtinës dhe i Peshterit (1970-1992). Në Shqipëri shërbeu si famullitar në Berdicë, Trush e Grudë të Re

(1992-1998). Gjatë kësaj kohe ishte themelues i Institutit Katekistik Kombëtar në Shkodër, edukator në këtë institucion dhe botues i revistës “Rrezja e dritës”, organ i këtij instituti. Në vitin 1998 nga Papa Gjon Pali II u emërua argjipeshkëv i Argjipeshkvisë së Tivarit. Ishte delegat i Papës Benedikti XVI në 100 vjetorin e lindjes së Nënë Terezës, në Prishtinë dhe në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, në Tiranë. Mori pjesë në katër sinode ndërkombëtare në Romë (1999, 2001, 2008 dhe 2014). Përktheu në gjuhën shqipe shumë tekste nga italishtja, kroatishtja e sllovenishtja dhe përgatiti për botim tekste të shumta liturgjike e katekistike. Botoi veprat

“Letra dhe dokumente të Pjetër Bogdanit”, “Kuvendi i Arbërit” (2003) etj., si dhe shkrime të shumta në revistën “Drita” dhe të përkohshmet tjera fetare. (Sarë Gjergji)

GASHI Kushtrim (1984-). Kompozitor, dirigjent. Lindi në Drenas. Pasi kreu shkollën e mesme të muzikës, studioi për kompozim dhe dirigjim orkestral në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Kreu studimet pasuniversitare për kompozim në Shkup, ndërsa për kompozim dhe dirigjim koral në Darmstadt, Gjermani. Ka përpunuar dhe kompozuar këngë korale, këngë solo, romanca (“Nënë, sa më prite”), vepra pianistike (“Pesë pjesë për piano”, “Revolution” për 4 duar, “Po vij në krushqit”), solistike-instrumentale (Moment për fag. e piano, Fantazia për klarinetë solo, C-is për trumbetë e piano, “Reflection” për violinë e piano), kamerale (Trio frymor, Polimorf për kuartet harkor), vokale dhe orkestrale-koncertale (Koncert, Poemë simfonike). Ishte asistent i Korit të Filarmonisë së Kosovës, themelues dhe drejtues i Orkestrës së të Rinjve në Kosovë, dirigjent i orkestrës kamerale “Rexho Mulliqi” dhe dirigjent-mysafir i “Jugendorchester” në Dornach, Zvicër. (Zeqirja Ballata)

GASHI Latif (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Dobërdol të komunës së Podujevës. Pasi përfundoi studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1986), punoi si sekretar në shkollën fillore “Azem Bejta” në Kërpimëh dhe Dobërdol. Kontaktet e para me UÇK-në i vendosi në fund të vitit 1996, ndërsa aktivisht u përfshi në radhët e saj në mars të vitit 1997. Në periudhën 1997-98 ishte koordinator i grupeve guerile në Zonën Operative të Llapit, anëtar i komandës dhe më pas shef i shërbimit informativ ushtarak të kësaj zone. Mori pjesë në shumë beteja të zhvilluara në anën e Llapit, si në betejën e Kaçandollit, të Llapashticës, të Peranit, të Majancit, në betejat e zhvilluara në fshatrat Bradash, Katunishtë, Buricë, pastaj në Llaushë-Dobërdol, në Surdull, në Potok, si dhe në mbrojtjen e spitalit ushtarak të UÇK-së në Siqevë, Pakashticë etj. Ishte pjesëmarrës edhe në betejën e fshatit Sylevicë, në fund të majit të vitit 1999, që u zhvillua për mbrojtjen e 10,000 civilëve. Pas luftës mori detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në institucionet civile të vendit. (Haxhi Ademi)

GASHI Liman (1971-). Gazetar i sportit. Lindi në Busi të Prishtinës. Filloi të punojë si gazetar në vitin 1999 në gazetën “Dita”. Ndërkaq nga viti 2000 e deri më 2003 ka qenë gazetar në gazetën “Bota sot”. Periudhën më të gjatë e kaloi në gazetën ditore “Kosova sot”, nga viti 2005 e deri në vitin 2014. Për disa muaj ka qenë pjesë e ekipit që nxori gazetën sportive “Arena”. (Florim Maliqaj)

GASHI Luan (1922-2005) Veprimtar, anti-komunist. Lindi në Elbasan, i biri i prof. Ahmet Gashit. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Elbasan. Në vitin 1937 nis mësimet në gjimnazin e Tiranës. Më 1943 u punësua në Prishtinë në gjimnazin “Sami Frashëri”. Mblodhi rreth vetes dhjetëra nxënës me bindje nacionaliste, të cilët më pas udhëhoqën çetat nacionaliste shqiptare. Nga shtatori i vitit 1944 luftoi kundër forcave partizane serbe dhe bullgare në Preshevë dhe në Prapashticë. Bashkëpunoi me Abdyl Hencin, Adem Gllavicën, Ibrahim Kelmendin, Ymer Berishën etj. Me Ibrahim Kelmendin morën Radio-Shkupin, e cila emitoi emisione në gjuhën shqipe. Gjatë vitit 1945-1946, i ndjekur nga OZN-a jugosllave, emigron në Greqi, pastaj në Itali, dhe në vitin 1956 në SHBA. Në SHBA kreu studimet në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe jep leksikone në Universitetin e Nju-Jorkut. Në fillim të viteve ‘60, me Jusuf Azemin, Ajet Rushitin etj., formojnë organizatën “Lidhja kosovare” dhe zgjidhet sekretar i saj. Ajo kontribuoi për njohjen e problemit kosovar në opinionin publik amerikan. Vdiq në Nju-Xhersi (SHBA). (Adem Murati).

GASHI Mark (1912-1990). Mësues, veprimtar i arsimit, i burgosur politik. Lindi në Zhegër të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në Zhegër, gjimnazin në Shkup, Akademinë Ushtarake të aviacionit në Mostar dhe në Zemun. Ishte njëri nga pilotët e rrallë shqiptarë në ushtrinë jugosllave. Më 1941 u arrestua nga bullgarët dhe më pas nga italianët. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte sekretar i komunës së Strezovcit, të Ropotovës dhe të Parallovës të nënprefekturës së Gjilanit. Kreu edhe detyra të tjera në administratën shtetërore. Së fundi ishte toger intendent në Ushtrinë Shqiptare (1944). Në nëntor të vitit 1944 inkuadrohet në Brigadën VII Plotësuese të Preshevës, në mars

të vitit 1945 u arrestua dhe u dënua me 20 vjet burg. Pas daljes nga burgu, punoi si mësues dhe drejtor shkolle në fshatin Caravajkë (Preshevë), më pas përgjegjës i arsimit në Preshevë. Në vitin 1958 u arrestua me Metush Krasniqin. Pas daljes nga burgu, bashkë me të shoqen mësuese, u detyrua të shpërngulej, një herë në Bosnjë dhe prej andej në Kumanovë, ku vazhdoi punën në arsim deri në fund të jetës. (Muhamet Shatri)


GASHI Masar (1949-). Mjek, internist, kardiolog, profesor universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1973). U emërua mjek në Qendrën Medicinale të Prizrenit. Specializimin e filloi në Klinikën Interne në Prishtinë dhe e përfundoi në Zagreb, ku kreu edhe studimet pasuniversitare. Mbrojtiti tezën e doktoratës më



MASAR GASHI

1987 në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Më 1980 u zgjodh asistent dhe në vitet vijuese mori titujt përkatës universitarë deri më 2002, kur u zgjodh profesor i lëndës së mjekësisë interne në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1981 në Zagreb u specializua për aplikimin e elektrostimulimit të përkohshëm të zemrës dhe një vit më vonë filloi implantimin e Pacemaker-it të përhershëm për herë të parë në Kosovë. Më 1987 qëndroi në Hjuston, Teksas të SHBA-së për ngritje profesionale. Që nga viti 1979 ishte shef i njësisë koronare në Klinikën Interne. Ishte kryetar i Shoqatës së Kardiologëve të Kosovës. Ka marrë pjesë në disa kongrese e simpoziume dhe ka botuar një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Bedri Zahiti)

GASHI Mirko (1939-1995). Poet dhe përkthyes. Lindi në Krlevë, Serbi. Kreu shkollimin fillor në Shkup dhe në Preshevë, gjimnazin në Gjilan. Ndoqi edhe një shkollë gazetarie. Punoi një kohë si mësues, pastaj si gazetar në Shkup dhe në Prishtinë. Shkroi kryesisht poezi dhe përktheu në gjuhën serbe poezi, drama dhe publicistikë të autorëve shqiptarë. Një kohë punoi në Teatrin e Kombësive të Shkupit dhe në Teatrin Krahinor të Prishtinës. Interpretio



MIRKO GASHI

role në filma artistikë e televizivë. Çoi një jetë bohemi, iu përkushtua thellësisht poezisë që shkruante dhe e deklamonte me emocion në takime poetike. Këmbëngulës te metafora e ujit dhe rrjedha e lumit, Gashi krijoi një

opus original dhe të veçantë në gjeneratën e tij. Konsiderohet nga poetët e rëndësishëm të viteve '70-'80 në Kosovë. Botoi përmbledhjet me poezi: "Në vorbullën e ujit" (1972), "Netët e bardha" (1975), "Libreto për gjenetivin e ujit" (serbisht) (1977), "Gjarpri i shtëpisë" (1980), "Arbor vitae" (1988) dhe "Plagë uji" (1990). Poezia e tij u përkthye dhe u botua në disa gjuhë të rajonit dhe më gjerë. (Eqrem Basha)

GASHI Mirushe (1964-). Mjeke, pediatër, hulumtuese shkencore. Lindi në Prishtinë, ku kreu Fakultetin e Mjekësisë. Në vitin 2002 u bë specialiste e sëmundjeve të fëmijëve (pediatër) në Universitetin e Prishtinës. Ishte për ngritje profesionale në Institutin "Ruxher Boshkoviq" të Zagrebit. Si përfituese e grantit të Këshillit Shkencor Norvegjez qëndroi disa muaj në Norvegji. Ndërkohë, u punësua në një kompani biomjekësore norvegjeze "Aqua Biotechnology" në cilësinë e hulumtueses. Gjatë punës hulumtuese në Universitetin e Bergenit, në vitin 2009 bëri zbulimin e proteinës Ll (leukolektin). M. Gashi është e doktoruara e parë në lëmin e biologjisë molekulare që vjen nga Universiteti i Prishtinës. Në Norvegji arriti afirmimin si eksperte ndërkombëtare, duke publikuar punime shkencore në revistat më prestigjioze shkencore. Jeton në Norvegji. (Remzije Belegu)

GASHI Muharrem (1936-). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe torakal, profesor universiteti. Lindi në Tërnoc të Bujanocit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Nish, kurse Fakultetin e Mjekësisë e përfundoi në Shkup (1963). Punoi dy vjet në Bujanoc. Kreu specializimin për kirurgji të përgjithshme në Beograd (1969). Ishte kryeshef i repartit të kirurgjisë dhe drejtor i Qendrës Mjekësore në Gjilan. Më 1972 u zgjodh asistent i lëndës kirurgji e përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në Beograd subspecializoi kirurgjinë torakale



MUHARREM GASHI

dhe më 1974 themeloi repartin e kirurgjisë torakale, të cilën e udhëheq deri në pensionim. Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, ndërsa temën e doktoratës e mbrojti në vitin 1978 në Fakultetin e Mjekësisë

në Prishtinë. Më pas mori titujt përkatës universitarë dhe u bë profesor i rregullt i kirurgjisë së përgjithshme dhe luftarake në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1985 u zgjodh dekan i Fakultetit të Mjekësisë. Gjatë viteve 1983-1984 qëndroi për aftësim profesional në Karolinën e Veriut, SHBA. Ka hartuar 4 tekste për studentë të Fakultetit të Mjekësisë, të studimeve pasuniversitare dhe për mjekë në specializim. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale. (Avdyl Krasniqi)

GASHI Musa (1928-). Gjeograf, profesor universitar. Lindi në Mitrovicë, u shkollua në vendlindje dhe në Prishtinë. Studimet e larta për gjeografi i mbaroi në Universitetin e Beogradit (1952), ku kreu edhe magistraturën nga lëmi i turizmit (1967). Mbrojti doktoratën në Universitetin e Prishtinës gjithashtu nga fusha e gjeografisë turistike (1973). Është i pari gjeograf specialist dhe doktor i shkencave në



MUSA GASHI

lëmin e turizmologjisë në Kosovë. Fillimisht punoi në arsim (1953-1961), më vonë në Entin Krahinor për Përparimin e Shkollave dhe si sekretar i Komisionit për Turizëm të Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës. Në vitin 1964 u emërua pedagogu i parë shqiptar në katedrën e gjeografisë të Universitetit të Prishtinës, ku kreu edhe detyrën e udhëheqësit të Seksionit të Gjeografisë. U pensionua në vitin 1991. Është hartues dhe pjesëmarrës i shumë projekteve profesionale shkencore. Në vitet 1965-1975, në bashkëpunim me ekspertë shkencorë zviceranë dhe francezë, mori pjesë në hartimin e studimit për mundësitë e zhvillimit të turizmit në Kosovë në periudhën 1965-2000, mandej realizoi studimin mbështetës për Sharrin si park

nacional (1974), për Mognën si monument natyror për mbrojtje, për bifurkacionin e Nerodimes etj. Është autor i shumë punimeve e kumtesave shkencore nga fusha e turiznologjisë, të botuara në vend dhe jashtë. Është hartues i teksteve universitare “Bazat e turizmit” (1986) dhe “Gjeografia rajonale - Afrika” (1981). M. Gashi është zgjedhur nënkryetar në Organizatën Botërore të Ekspertëve të Turizmit me qendër në Bernë dhe ka mbajtur disa funksione në organizatat turistike të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. (Vahdet Pruthi)

GASHI Naim (1971-). Oboist. Shkollën e mesme të muzikës e mbaroi në Prishtinë, ndërsa studimet për obo në Akademinë e Muzikës në Lubjanë (1995), në klasën e prof. B. Rogelja. Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Konservatorin e Lozanës në Zvicër, në klasën e prof. Jean-Paul Goy (2001). Ka marrë pjesë si oboist në koncerte të ndryshme solistike, kamerale dhe orkestrale. Është shpërblyer me një sërë çmimesh. Ishte anëtar i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit të Sllovenisë (1992-1993), oboist-solist në Orkestrën e Teatrit të Operës e Baletit të Lubjanës (1992-1997). Është anëtar i formacioneve të ndryshme muzikore kamerale dhe orkestrale në Zvicër, ku jeton dhe vepron aktualisht. (Kristina Palokaj-Perkola)

GASHI Nazif (1951-). Boksier. Lindi në fshatin Mramor të Prishtinës. Konsiderohet një prej boksierëve më luftarakë në Kosovë. Për dhjetë vjet radhazi (1970-1980) ishte anëtar i KB “Prishtina”. Me këtë klub fitoi pesë tituj të kampionit të ish-Jugosllavisë. Për katër vjet rresht ishte anëtar standard i përfaqësueses së ish-Jugosllavisë në boks. Në vitin 1974 e fitoi turneun “Ngadhënjyesi i Bogradit”, ndërsa në dy vitet vijuese (1975, 1976) fitoi turneun “Gongu i Artë” në Shkup. Në periudhën 2002-2005 ka qenë përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës në boks. (Bekim Aliu)

GASHI Nebih (1927-1994). Funkionar politik në periudhën e autonomisë së Kosovës. Lindi në Busi të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në Slivovë. Shkollën e mesme e kreu pas demobilizimit, kurse Fakultetin Juridik në vitin 1965 në Prishtinë. Më 1945 u mobilizua në Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, me çrast përjetoi masakrën e Tivarit. Më pas u

sëmur dhe u mjekua në Spitalin e Dubrovnikut dhe të Zarës. Po gjatë kësaj periudhe kreu një kurs për epror ushtarak, mori gradën e majorit dhe u anëtarësua në Partinë Komuniste të Jugosllavisë. Pas demobilizimit më 1948 u angazhua në organet politike dhe shtetërore, së pari në komunën e Prishtinës dhe pastaj në ato krahinore. Për një periudhë të gjatë (1967-1985) ishte anëtar i kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve (LK) të Kosovës, ndërsa në vitet 1982-1983 ishte kryetar i Komitetit Komunal të LK të Prishtinës. Për disa mandate ka qenë deputet i Kuvendit Krahinor, pastaj deputet federativ, anëtar i Kryesisë së Kosovës dhe një vit (1986) kryetar i saj etj. U angazhua për të drejta të barabarta të shqiptarëve në arsim, punësim etj. Njijhej për diskursin e ashpër ndaj nacionalizmit shqiptar dhe shovinizmit serb, sidomos pas demonstratave të vitit 1981. (Zijadin Gashi)

GASHI Osman (1962-). Poet, mësimdhënës universitar. Lindi në fshatin Mramor të Prishtinës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, ku më pas mbaroi dhe studimet



OSMAN GASHI

për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i bëri në Zagreb dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Ka punuar një kohë si gazetar dhe përkthyes në të përditshmen “Rilindja”, ndërkaq nga viti 1989 në Fakultetin e Filologjisë të UP-së është ligjërues i letërsisë botërore dhe letërsisë krahasimtare. Ka botuar këto vepra me poezi: “Përtej harresës” (1999), “Lumenjtë qiellorë” (2004) “Torzo e gjallë” (2007), si dhe librat studimorë: “Studime interliterare” (2001), “Miti dhe romantizmi evropian” (2005), “Kufijtë e letërsisë” (2008), “Letërsia dhe miti” (2014). Me veprën e fundit ka marrë çmimin e Ministrisë së Kulturës për librin më të mirë studimor. Ka botuar edhe një varg shkrimesh në revista të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare dhe ka marrë pjesë në seminare e konferenca shkencore. (Adil Olluri)

GASHI Qëndrim (1984-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë. Pas



QËNDRIM GASHI

shkollës fillore, si talent i jashtëzakonshëm, iu krijua mundësia të vijojë studimet në departamentin e matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 2002.

Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Kembrixhit dhe në Universitetin e Çikagos. Studimet e doktoratës i përfundoi në Çikago (2008). Botoi disa punime shkencore në revista ndërkombëtare. Veprimtaria shkencore e Q. Gashit i takon gjeometrisë algebrike dhe teorisë së përfaqësimeve. Ka marrë pjesë me kumtesa në shumë tubime shkencore. Është laureat i disa mirënjohjeve dhe çmimeve mbështetëse: i çmimit mbështetës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2014), “Shkencëtar i ri” nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012), i çmimeve për studime dhe mësimdhënie në Çikago (2007), Kembrixhit etj. Është themelues i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës (2008) dhe anëtar i Shoqatës së Matematikanëve të Europës (EMS) dhe të Londrës (LMS), si dhe anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve në Salzburg (2014). Më 2016 u emërua ambasador i Republikës së Kosovës në Francë. (Qamil Haxhibeqiri)

GASHI Rexhep (1940-2017). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe Shkollën Normale i kreu në Prishtinë, studimet për fizikë i kreu në Fakultetin Filozofik po në Prishtinë (1965). Një kohë punoi në Shkollën e Mesme Teknike, më pas u zgjodh asistent në katedrën e fizikës të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1968). Studimet pasuniversitare nga fizika bërthamore i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit (1974), tezën e disertacionit të doktoratës e punoi në Institutin për Energji Bërthamore të Vinçës, ndërsa e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1977). Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shtetërore të Kosovës. Është autor i tekstit universitar “Fizika për studentët e mjekësisë” dhe i teksteve për shkolla të mesme. Ka botuar punime shkencore dhe profesionale në revista ndërkombëtare dhe

vendore. Është bartës i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Zahadin Shemsedini)

GASHI Rexhep (1960-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Hallaç të Vogël, komuna e Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në fshatin Rufe i Ri, të mesmen në Lipjan, ndërsa diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP). Në vitin 1984 u zgjodh asistent për lëndën kriminologjia me penologji në Fakultetin Juridik të UP-së. Në vitin 1992 magjistroi, ndërsa në vitin 2001 po në Fakultetin Juridik të UP-së mbrojti doktoratën. Në vitin 2012 u zgjodh profesor i rregullt për të njëjtën lëndë. Ligjëroi edhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Kreu detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet shtetërore të Kosovës. Qëndroi për hulumtime shkencore në disa qendra universitare, si në Universitetin Shtetëror të Arizonës, në Institutin për Kriminologji të Universitetit të Kembrixhit, në Universitetin e Gracit (2010) dhe në Universitetin e Uashingtonit. Është autor i shumë punimeve shkencore dhe i disa botimeve të veçanta: “Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri” (2001), “Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989” (2003) etj. (Blerim Reka)

GASHI Salih (1944-). Kimist, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Baran të Pejës, shkollimin e kreu



SALIH GASHI

në vendlindje, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit në vitin 1966. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Teknologjik të Universitetit të Zagrebit (1971). Punoi në kombinatin “Trepça”, në minierat dhe flotacionin Kishnicë dhe Novobërdë, si udhëheqës i laboratorit të kimisë. U zgjodh asistent i kimisë fizike në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (UP) më 1972. Tezën e disertacionit e mbrojti në Universitetin e Zagrebit (1978). Për qëllime studimore qëndroi në disa laboratorë (Universiteti i Bërnos, Instituti Hidroprojekt). Studimet e postdoktor-

atës i kreu në departamentin e kimisë të Universitetit të Aberdeen-it në Skotlandë (1979) dhe në Universitetin e Exter-it (1987). Në vitet vijuese zgjidhet profesor inordinar dhe ordinar për lëndën kimia fizike. Në vitin 1988 bëhet anëtar i Shoqatës Europiane të Shkencës dhe të Teknologjisë së Membranave. S. Gashi përgatiti për herë të parë membranat heterogjene të osmozës reverse në Universitetin e Prishtinës. Ka ushtruar detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë dhe ka qenë kryetar i Kuvendit Komunal të Prishtinës (2001-2003). Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u zgjodh në vitin 2012. Ka publikuar punime në revista shkencore në vend dhe jashtë, kumtesa në tubime shkencore, projekte shkencore dhe është përfshirë si bashkautor në tekstin “Kimia për mbrojtjen e mjedisit” (“Chemistry for protection of the Environment”, Elsevier, Amsterdam, NewYork, Oxford) etj. (Nexhat Daci)

GASHI Sanije (1944-). Gazetare. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor, shkollimin e mesëm dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike. Ndoqi studimet në Fakultetin Filologjik të Uni-



SANIJE GASHI

versitetit të Prishtinës. Nis të punojë gazetare në vitin 1965, në revistën “Zëri i rinisë”. Në nëntor të vitit 1971 emërohet redaktore në revistën për femra “Kosovarja”, që doli po atë vit, kurse më 1975 emërohet kryeredaktore e kësaj reviste. Revistën “Kosovarja” e drejtoi për 18 vjet me radhë. Në maj të vitit 1994 themeloi revistën e parë të pavarur për gruan dhe familjen, “Teuta”. Është ndër të parat gazetare shqiptare, e cila bëri gazetari aktive përreth gjysmë shekulli pa ndërprerje. Gjatë viteve ’90 të shekullit të kaluar u përfshi në zhvillimet politike të kohës. Ishte njëra nga themelueset e Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përveç punës në medie, u angazhua edhe në aktivitete për zhdukjen e analfabetizmit dhe për barazi gjinore. Më 2014 botoi librin “Prishtina e fëmijërisë sime”. (Shefqet Rexhepi)

GASHI Sinan (1947-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Arllat të Drenicës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën Normale dhe

studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Mbaroi studimet pasuniversitare po ashtu në Universitetin e Prishtinës. Një kohë të gjatë punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Drenasit, pastaj si gazetar në të përditshmen “Bota sot”. Në gazeta dhe revista botoi shkrimet publicistike dhe nga fusha e kritikës letrare. Botoi një sërë veprash nga kjo fushë: “Nonda Bulka - krijimtaria letrare” (1995), “Vlerësime, preokupime, përimtime” (2004), “Arti letrar si terapi shpirtërore” (2012), “Poeti idealist” (2014). Kjo e fundit është një monografi letrare kushtuar Fazli Greiçevcit. (Hasan Hasani)

GASHI Skender (1942-). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në Mramor të Prishtinës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, studimet e rregullta i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit. Në Salzburg kreu studimet e doktoratës dhe mbrojti tezën e disertacionit për emrat e shqiptarëve në shekujt XIV-XV sipas burimeve kishtarë serbe (1984). Për shkak të veprimtarisë së tij u burgos dy herë (1962, 1963). Gjithashtu u përjashtua nga puna dy herë, më 1966 dhe 1969. Punoi si përkthyes nga gjuha serbe në gjuhën shqipe në administratën komunale të Lipjanit (1976) dhe në Kombinatin “Kosova” të Obiliqit dhe më pas si lektor në gazetën “Rilindja” (1969). Në vitin 1973 u punësua në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Në periudhën 1980-2003 punoi si lektor i gjuhës shqipe në Vjenë. Nga viti 1990, po në Vjenë, botoi revistën shkencore dhe publicistike “Dardania”. Ishte aktiv në tubimet dhe aktivitetet e Institutit Albanologjik në fushën e onomastikës. Botoi punime dhe studime shkencore nga kjo fushë dhe i realizoi këto projekte shkencore të Institutit Albanologjik: “Fjalori toponimik kronologjik i Kosovës me vendbanime ekzistuese dhe vendbanime të zhdukura” (dy vëllime), “Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve popullore” (bashkautor, 1982). Botoi veprat “Emrat e shqiptarëve në shek. XIII-XV në dritën e burimeve kishtarë serbe” dhe së fundi, “Kërkime onomastike-historike për minoritete të shuara e aktuale të Kosovës” (2015). (Naim Berisha)

GASHI Sulejman (1959-). Gazetar. Lindi në Kumanovë. Në Kijevë të Malishevës mbaroi shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi angleze i mbaroi në Fakultetin Filologjik të Universitetit të

Prishtinës. Gjatë viteve 1983-1988 punoi mësimdhënës në gjimnazin e Kijevës dhe të Klinës. Nga viti 1988 nis punë si gazetar-reporter në TV Prishtina (RTP). Më 1990, pas mbylljes së dhunshme të RTP-së nga Serbia, emigroi në SHBA. Deri në vitin 1999 raportoi nga Nju-Jorku për mediet në gjuhën shqipe “Rilindja”, “Bujku”, programi për Kosovën në Radio-Zagreb dhe më pas për Radiotelevizionin Shqiptar. Ishte bashkëthemelues i gazetës shqiptaro-amerikane “Illyria” në Nju-Jork. Pas çlirimit të Kosovës më 1999, emërohet këshilltar për medie i shefit të UNMIK-ut, Bernard Kushner, dhe koordinator i UNMIK-ut për themelimin e medieve elektronike publike në Kosovë, Radio Televizionit të Kosovës dhe Radios “Blue Sky”. Nga shtatori 2003 kthehet në SHBA, si korrespondent i RTK-së. Përveç me gazetari merret edhe me përkthime. Jeton në Nju-Jork. (Zenun Çelaj)

GASHI Shaban (1920-1971). Aktor. Lindi në Ferizaj. Karrierën e tij prej aktori e nisi në Teatrin Popullor Krahinor në vitin 1954, ku ishte i angazhuar deri në fund të jetës. U veçua në interpretimin e roleve dytësore. Përgjatë viteve ‘60 realizoi dhjetëra role të këtitlla në shfaqjet e zhanreve të ndryshme të autorëve vendorë dhe të huaj. Ndër më të realizuara veçohen rolet e tij në shfaqjet: “Nuk marthohem me parë”, “Shërbëtori i dy zotnive”, “Nita”, “Halit Gashi”, “Parajsa e humbur”, “Oda e errët”, “Halili dhe Hajria” etj. Disa nga shfaqjet e tjera, në të cilat u angazhua janë edhe: “Berberi i Seviljes”, “Kryet e hudrës”, “Njerëzit”, “Ciklonët”, “Bashkëshortët”, “Dy metelikë”, “Paradoksi i Diogjenit”, “Tartufi”, “Vinetu”, “Magjistarja”, “Fosilet”, “Othello”, “Duart e papastra”, “Ruaje fshehtësinë time” etj. (Arian Krasniqi)

GASHI Shpresa (1950-). Soprano. Lindi në Pejë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren dhe u dallua për cilësi interpretimi. Mësuese e muzikës në Pejë, më 1970 u regjistrua dhe më pas e kreu Akademinë e Arteve, dega e teorisë së muzikës, duke e përkryer zërin në Zagreb, Shkup e Tiranë. Një kohë ishte pjesëtare e Ansambllit “Universitas Studiorum Zagrebiansis” që e kultivonte muzikën e renesansës. Pas themelimit të Televizionit të Prishtinës ishte bashkëpunëtoare e muzikës serioze, ilustruese dhe drejtuese emisionesh muzikore. Një pjesë e karrierës së saj lidhet me Radiotelevi-



SHPRESA GASHI

zionin e Prishtinës. Me themelimin e Korit të RTVP-së u bë soliste e tij. Ka kënduar në festivale muzikore në hapësirën shqiptare dhe më gjerë, në Europë, SHBA e Australi. Lirizmi prej sopranoje me kolorit të veçantë është i pranishëm në shumë incizime, i vlerësuar me çmime, përfshirë dhe këngët në duo. Është shpërblyer në Festivalin Gjithëkombëtar në Shkodër, në “Akordet e Kosovës”, e nderuar me “Mikrofon të artë”, me çmimin e karrierës në Tiranë. Laryshia interpretuese dhe timbri i vokalit të saj vërehen tek interpretimet e këngëve të njohura popullore: “Midis ballit ma ke një pikë”, “Qenke nur i bukurisë”, “Kroi i fshatit tonë” etj. Është pjesëtare e Korit të Filarmonisë së Kosovës. (Sami Piraj)

GASHI Xhafer (1944-2010). Inxhinier i teknologjisë, mësimdhënës universitar. Lindi në fshatin Mramor, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë (1963), ndërsa studimet e larta i kreu në Fakultetin Metalurgjik-Teknologjik të Universitetit të Beogradit (1968). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit (1975). Punoi si inxhinier në Flotacionin e Minierave në Kishnicë të Novobërdës dhe ishte bashkëpunëtor i lartë profesional për teknologji dhe metalurgji në Këshillin Ekzekutiv të Qeverisë së Kosovës (1970). Kreu detyra me përgjegjësi: drejtor teknik, drejtor i prodhimit, drejtor i zhvillimit, zëvendësdrejtor gjeneral, drejtor i damperit në Fabrikën e Gomës dhe Kimike “Ballkan” në Suharekë (1970-1985), drejtor i sektorit të kimisë dhe të energjetikës (Tertorja, Ngrohtorja, Gazifikimi dhe Azotiku) (1985-1988) dhe drejtor i Termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”. U zgjodh ligjërues për lëndët: instrumentet matëse dhe bazat e automatikës dhe termodinamika në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik të Universitetit të Prishtinës (1995-2000). Gjatë periudhës 1999-2004 ishte inxhinier përgjegjës për djege në Inxhiniering të Termocentralit “Kosova B”. (Ali Gashi).

GASHI Xheladin (1946-2005). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Komoran, komuna e

Drenasit. Pasi kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike për kimi-biologji në Shkup (1973), punoi si mësimdhënës në Komoran dhe Nekoc. Gjatë viteve '90 ishte njëri ndër aktivistët e shquar për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur. Ishte njëri ndër themeluesit e UÇK-së. Në vitin 1997 u largua nga Kosova për në Zvicër, ku u mor aktivisht me mbledhjen e fondeve për luftën çlirimtare. Me fillimin e luftës në Kosovë, nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-se u emërua përgjegjës për furnizim me armatim për zonën e veriut të Shqipërisë. Pas përfundimit të luftës u angazhua në ndërtimin e institucioneve të vendit. Vdiq nga një sëmundje e rëndë. Në vitin 2013 nga presidentja e Kosovës iu akordua Urdhri "Hero i Kosovës". (Ismail Sylja)

GASHI Xhevat (1953-1999). Mjek i përgjithshëm, dëshmor. Lindi në Kosuriq të Pejës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Punoi në Trestenik, në Treboviq dhe në Shërbimin e Urgjencës në Pejë. Pas largimit të punëtorëve me dhunë nga pushteti serb, ishte aktiv në sindikatat e mjekëve. Dha kontribut të veçantë në kohën e helmimit masiv të nxënësve dhe fëmijëve shqiptarë nga pushteti serb. Për punën dhe veprimtarinë e tij disa herë u mor në biseda informative. U rrëmbye më 20 janar 1999, duke shkuar në punë dhe më 21 janar u gjend i vrarë në fshatin Prekallë të Istogut. (Ibrahim Rexhaj)

GASHI Xhevdet (1955-). Kompozitor, aran-zhues, elektroinxhinier. Lindi në Krushec të Skënderajt. Në Mitrovicë kreu shkollën fillore, të mesme dhe të ulët të muzikës. U diplomua në Fakultetin Elektroteknik (1980). Kryeinxhinier i RTP-së në vitet 1980-1985 dhe në Bankën e Kosovës (1985-1991). Më 1991 themeloi ndërmarrjen për produksion muzikor dhe shërbime teknike "Sonus". Nga viti 2008 është drejtor teknik në Radiotelevizionin 21. Themeloi rok grupin "Mak" (1973) ndër të parët të ne me orientim folk-rock. Realizoi produksionin e mbi 2000 këngëve. Komponon, orkestron për formacione të orkestrës simfonike, revyale e big-bande. Mori pjesë në "Akordet e Kosovës", në festivalet e Suboticës, Opatisë, Radencit, Radiotelevizionit Shqiptar etj. Kompozimet, orkestrimet, produksionet më të spikatura i ka në gjinitë pop, rock, folk, klasik ("Moj e mira te pojata", "Qenke rrit moj,

s'po t'ze këmisha", "Ndarja pa fjalë", "Fshatarja ime", "Pema e lirisë" etj.). Është autor i muzikës për shfaqjet "Babai", "Pylli është i të gjithëve" dhe "Garderobisti". U shpërblye në "Akordet e Kosovës" (1976, 1979), në Festivalin "Rinia këndon" (1974, 1975, 1976) etj. (Indira Çipa)

GASHI Yllka (1982-). Aktore. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës më 2004. Ishte aktive në teatër, film dhe televizion.



YLLKA GASHI

Me një sërë rolesh u paraqit në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin "Dodona" dhe në Teatrin "Oda". Luajti një sërë rolesh në filma të metrazhit të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Qe aktive edhe në seriale televizive. Njohjen më të madhe publike e fitoi me personazhin e Zanës në serialin "Familja moderne", prodhim i RTK-së, i cili u transmetua në vazhdimësi për 10 vjet me radhë. Deri më tani ka fituar edhe tre çmime ndërkombëtare: çmimin "Marta 2004" si aktorja më e mirë e Festivalit "Setkani-Encounter" në Bërno të Çekisë, çmimin "Apollon 2010" si aktorja më e mirë e festivalit në qytetin Fierit në Shqipëri dhe çmimin "Ensemble Acting Award" në Nju-Jork më 2011. Në vitin 2006 zyra e UNICEF-it në Kosovë e zgjodhi Y. Gashin ambasadore të vullnetit të mirë. Në vitin 2014 zyra e Fondacionit "Save the Children" në Kosovë e zgjodhi ambasadore-artiste në fushatën e mësimin për fëmijët me nevoja të veçanta. (Jeton Budima)

GASHI (Hasim) Zijadin (1944-). Veprimtar i arsimit shqip. Lindi në Busi të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në Mramuer, shkollën normale (1964) dhe studimet për histori i kreu në Prishtinë. Punoi në disa shkolla në periudhën 1964-1976, ndërsa më pas, deri në vitin 1990 inspektor i arsimit në Prishtinë. Në vitet 1991-2000 kreu detyrën e sekretarit, kryetarit të këshillit dhe të drejtorit për arsim në komunën e Prishtinës dhe të inspektorit të arsimit në Ministrinë e Arsimit të Kosovës (2000-2009). Ishte njëri ndër themeluesit dhe anëtar i kryesisë së Lidhjes së arsimtarëve shqiptarë "Naim Frashëri". U angazhua për pavarësimin e shkollës shqipe në Kosovë dhe për organizimin e mësimin në kushtet e okupimit gjatë viteve '90.

Për shkak të kësaj veprimtarie u burgos disa herë nga pushteti serb. Është autor i shkrimeve publicistike dhe i disa veprave të botuara: "Ditët e tmerrit dhe të shpresës (ditar i luftës)" (2000), "Dhuna dhe krimet serbe në shkollat e Komunës së Prishtinës (mars-qershor 1999)" (2003), "Mbijetesa dhe pavarësia e shkollave fillore në Komunën e Prishtinës 1990-1999" (2014) dhe "Shtëpitë shkolla në fotografi" (2016). (Fehmi Rexhepi)

GASHI Zijadin (1973-). Gazetar. Lindi në Busi të Prishtinës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ku kreu edhe studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Është trajnuar për gazetari në SHBA dhe nga Institutit i Medies dhe Komisioni Europian (2010). U angazhua në gazetarinë e shkruar dhe elektronike, duke raportuar rregullisht për çështjet kryesore politike në vend. Në periudhën 1998-2001 ishte gazetar dhe kolumnist në të përditshmen "Kosova sot", më pas (2001-2012) gazetar në të përditshmen "Zëri", kurse nga viti 2012-2014 gazetar-komentues në të përditshëm "Tribuna". Ndërkohë, që nga viti 2001 vazhdoi të punojë në Radion "Evropa e Lirë". Ka fituar çmime dhe mirënjohje për punë profesionale. (Artan Krasniqi)

GASHI-DAUTI Nerxhivane (1960-). Juriste, profesore universiteti. Lindi në Zabelin e Ulët, komuna e Drenasit, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, kurse u diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP). Në vitin 1984 u zgjodh asistente për lëndën e drejta e detyrimeve. Studimet pa-suniversity, drejtimi civil-juridik, i kreu po në Fakultetin Juridik të UP-së, ku edhe dokto-



NERXHIVANE
GASHI-DAUTI

roi në vitin 2000. Ka mbajtur ligjërata edhe në Fakultetin Juridik të USH të Tetovës. Në periudhën prill 2001-2002 ishte këshilltare në Këshillin e Përbashkët Legjislativ të Kosovës, si dhe deputete në Kuvendin e Kosovës në tri legjislatura (2001-2010). Ka botuar punime shkencore në revista dhe publikime të tjera profesionale dhe është autore e disa teksteve universitare: "E drejta e detyrimeve-Pjesa e përgjithshme" (2013), "Kontratat" (2012), "E drejta kontraktuese" (2011) etj. (Osman Ismaili)

GAZETA "BOTA PRESS". Gazetë e përditshme, e cila filloi botimin në shkurt të vitit 2014 dhe, në versionin e shtypur, u botua deri në korrik të vitit 2015. E themeluar nga një grup gazetarësh, kjo gazetë së fundi kaloi në edicionin online. Ndjek zhvillimet politike, shoqërore dhe kulturore në Kosovë. (Bajrush Morina)

GAZETA "BOTA SOT". Gazetë e përditshme, e cila filloi botimin në qershor të vitit 1995 në Zvicër. Ekipi i gazetarëve në Prishtinë, në krye me shkrimtarin Teki Dervishi përgatitnin shkrime nga fusha të ndryshme, me theks nga proceset politike që zhvillohen në Kosovë gjatë viteve '90. Redaksia në Zvicër e plotësonte edicionin me shkrime për diasporën, nga radhët e së cilës ishin edhe lexuesit kryesorë. Pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, gazeta "Bota sot" filloi edhe edicionin e Kosovës. Gjatë periudhës së pasluftës, gazeta ndoqi zhvillimet më të rëndësishme politike në Kosovë, duke u bërë mbështetëse e fjalës së lirë dhe e demokratizimit të shoqërisë. Së fundi gazeta "Bota sot" botohet në Nju-Jork të SHBA-së. Përveç edicionit të shtypur, gazeta ka edhe edicionin online. (Bajrush Morina)

GAZETA "DARDANIA". Gazeta e përditshme, që nisi botimin në një shtypshkronjë të Shkupit javën e tretë të futjes së trupave të NATO-s në Kosovë, në korrik të vitit 1999. Transportohej nga Shkupi në Prishtinë, ndërsa shpërndahej edhe në disa qytete të Kosovës. Gazeta u botua deri në prill të vitit 2000. Botues i gazetës ishte Gani Mehmetaj, ndërsa kryeredaktor Ali Mehmetaj, me seli në Prishtinë. Ishte gazetë informative-analitike, e cila u përqendrua në temat që kishin të bënin me ngjarjet e pasluftës, veçmas në procesin e përballimit të pasojave nga shkatërrimet dhe vrasjet masive, që i kishte lënë mbas ushtria dhe policia e Serbisë. (Ibrahim Berisha)

GAZETA "DITA". Gazetë e përditshme, që u botua për një vit në Prishtinë (2000-2001). Gazeta kishte staf me përvojë, të cilit i printe Behlul Beqaj. Gazeta u përqendrua në gazetari hulumtuese, duke vënë theksin në drejtësinë e pasluftës në Kosovë. Për një vit të botimit gazeta u dënua dy herë, me pretekstin e ndërkombëtarëve se 15 muaj pas luftës nuk duhej dhënë detaje mbi rreth 450 masakra, sepse në këtë mënyrë mund të rrezikohej

jeta e personave të dyshuar. Me këtë gazetë u mor disa herë bordi i medieve, komisionari ndërkombëtar dhe zyrtarë të tjerë politikë dhe administrativë, të vendit dhe të huaj. Çështja e gazetës "Dita" u bë sinonim i lirisë së kufizuar të shtypit në Kosovë në periudhën e administrimit ndërkombëtar. (Artan Krasniqi)

GAZETA "EXPRESS". Gazeta e përditshme e pavarur, e cila filloi botimin më 2005. U themelua nga një grup gazetarësh dhe u financua nga kompania e telefonisë mobile IPKO. Kryeredaktor i parë ishte Dukagjin Gorani (2005), me pas Berat Buzhala (2007) dhe Leonard Kërquku. Nga 20 nëntori i vitit 2008 nisi nga puna edhe portali "Gazetaexpress.com", ndërsa nga marsi i vitit 2013, pas daljes 8-vjeçare, u ndërpre versioni i shtypur i gazetës. "Gazetaexpress.com" aktualisht është ndër gazetatat online më të mëdhatë në Ballkan dhe më i vizituari nga mediet shqiptare. Ka lexueshmëri të gjerë në Kosovë, në Shqipëri, në Mal të Zi, në Maqedoni, në Luginë të Preshevës dhe posaçërisht në diasporën shqiptare. Përmbajtja e "Gazetaexpress.com" përditësohet brenda 24 orëve, çdo ditë, nga gazetarët që punojnë ekskluzivisht për këtë portal. (Artan Krasniqi)

GAZETA "FLAKA" ("FLAKA E VËLLAZËRIMIT"). Gazeta e parë dhe më e rëndësishme në gjuhën shqipe që u botua në Maqedoni. E nisi botimin në Shkup nga 4 prilli i



NUMRI I PARË I GAZETËS "FLAKA E VLLAZNIMIT"

vitit 1945, si organ i Frontit Nacional-Çlirimtar për shqiptarët e Maqedonisë. Në fillim u botua me emrin "Flaka e vllaznimit", më pas "Flaka e vëllazërimit", kurse pas viteve '90 vetëm "Flaka". Ishte gazeta e vetme në gjuhën shqipe në Maqedoni deri në rënien e sistemit njëpartiak.


Themelues i saj konsiderohet ministri i parë shqiptar në qeverinë e Maqedonisë socialiste, dr. Nexhat Agolli, kurse drejtor dhe kryeredaktor i parë ishte dr. Petro Janura. Në fillim ishte gazetë dyjavore (1945), pastaj u bë javore (1958), pastaj u botua tri herë në javë (1977), kurse nga 1994 u bë e përditshme. Kjo gazetë u shua në vitin 2003, pasi u privatizua. Gazeta botonte lajme, komente, reportazhe, intervista, si dhe kishte shtojcat për kulturë, rini, sport etj. Në faqet e kësaj gazete u afirmuan shumë emra të gazetarisë shqiptare jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajon. Ndërkaq, ndërmarrja botuese "Flaka" botonte revistat për fëmijë: "Gëzimi" (1950) dhe "Fatosi" (1955) dhe revistën për art, shkencë dhe kulturë "Jehona" (1962). Këto revista janë shtypur në disa mijëra kopje. Gazeta "Flaka e vëllazërimit" dhe revistat kanë luajtur rol të rëndësishëm në ngritjen kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë, edhe pse kanë qenë gjithnjë nën mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore dhe politike. Gazeta "Flaka" në vitet '80 të shekullit të kaluar ishte i vetmi medium publik që refuzoi të shkruante toponimet sipas gjuhës maqedonase (Skopje për Shkupi, Tetovo për Tetovë, Kiçevo për Kërçovë, Debar për Dibër etj.). Si ndërmarrje botuese "Flaka", në edicionin e saj ka botuar qindra libra letrarë, studimorë, publicistikë dhe libra të përkthyer nga gjuhë të ndryshme. Disa nga kryeredaktorët e saj kanë qenë: Petro Janura, Lutfi Rusi, Rexhep Zllatku, Fejzi Bojku, Daut Dauti, Ahmet Selmani, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi etj. (Salajdin Salihu)

GAZETA "INFOPRESS". Gazeta e përditshme. Filloi të botohej në vitin 2006, e themeluar nga gazetari Rexhep Hoti. Për një kohë të shkurtër arriti shtrirje solide në tregun medial të Kosovës. Kishte formatin dhe dizajnin e tabloidëve. Për një kohë gazeta tuboi rreth vetes emra të njohur gazetarësh dhe analistësh. Në dhjetor të vitit 2011 gazeta "Infopress" pushoi së botuari si pasojë e rënies së tirazhit dhe shitjes. (Artan Krasniqi)

GAZETA "JAVA". Gazetë e përjavshme, që u botua në periudhën 2001-2008. Gazetën e themeloi Migjen Kelmendi, i cili ishte njëkohësisht edhe kryeredaktor i saj. Java veçohet për polemikat rreth shqipes standarde dhe shumica e shkrimeve të saj botoheshin në dialektin gegë. Gazeta u përpoq të krijonte hapësirë për debate rreth temave të ndjeshme të

shoqërisë kosovare, si identiteti, gjuha, flamuri, shteti, feja. Gazeta u botua me tri suplemente: njërin që iu kushtua debatit të çështjes së identitetit kosovar; suplementin që iu kushtua debatit rreth standardit gjuhësor të vitit 1972 dhe suplementin kushtuar kulturës urbane. Në vitin 2008 gazeta e ndërpreu versionin e shtypur dhe vazhdoi edhe për një kohë në versionin online. (Artan Krasniqi)

GAZETA “JEDINSTVO”. Gazetë e Kosovës në gjuhën serbe. Numri i parë doli në fund të dhjetorit të vitit 1944 në Prizren, si pamflet i komunistëve dhe i partizanëve serbë në Kosovë.



Gazeta në fillim u botua një herë në javë, ndërsa nga viti 1969 dy herë në javë. Ndërkohë, doli si organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës. Nga viti 1977 nis të dalë si e përditshme. Tirazhi ditor i botimit ishte rreth 5,000 ekzemplarë. “Jedinstvo” në fillim ishte vetëm gazetë informative-politike, ndërsa në vitet ‘70 u zgjerua edhe me shtëpinë botuese të librit letrar dhe të revistave, ndër të cilat më e njohura ishte revista letrare “Stremljenja”. Në kuadër të gazetës, të shtëpisë botuese dhe të redaksive të revistave punuan emra të njohur të kulturës dhe të letërsisë serbe në Kosovë, si: Rade Nikoliq, Vuk Filipoviq, Lazar Vučkoviq, Radoslav Zlatanoviq, Darinka Jevriq, Mosha Odaloviq, Radosav Stojanoviq, Slobodan Kostiq, Ismet Markoviq, Mirko Zhariq, Aco Rakoçeviç etj. Mbas vitit 1981 gazeta “Jedinstvo” bëhet pjesë e fushatave antishqiptare, duke nxitur popullsinë serbe në Kosovë të armiqësohet me shumicën shqiptare. Gazeta iu bëri jehonë të gjitha proceseve nacionaliste serbe që u zhvilluan në Beograd, përfshirë edhe mbështetjen pa rezervë ndaj politikës së Millosheviqit dhe gjenocidit të Serbisë në Kosovë. Mbas vitit 1990, kur u mbyll

gazeta e përditshme “Rilindja”, ndërmarrja “Jedinstvo” ndërroi emrin në “Panorama” dhe mori nën kontroll shtypshkronjën e “Rilindjes” dhe Pallatin e Shtypit. Mbas vitit 1999, gazeta “Jedinstvo” vazhdoi të botohet në veri të Mitrovicës, në kuadër të ndërmarrjes “Panorama”, duke ndjekur diskursin antishqiptar dhe politikat redaktuese kundër pavarësisë së Kosovës. (Ibrahim Berisha)

GAZETA “KOHA DITORE”. Gazetë e përditshme e pavarur e Kosovës, numri i parë i së cilës doli më 31 mars 1997. U themelua nga publicisti Veton Surroi. Dalja e gazetës u



përgatit nga ekipi i gazetarëve dhe i redaktorëve të javores “Koha”, e cila e kishte nisur botimin që nga viti 1990. Gazeta kishte në përbërje të redaksisë një gjeneratë të re të gazetarëve të Kosovës dhe me mënyrën e re të raportimit, të mbështetur në praktikat perëndimore të ndarjes së qartë të opinionëve prej lajmeve, shumë shpejt mori primatin në shtypin e asaj kohe në Kosovë. Gjatë periudhës së luftës në Kosovë (1998-1999) gazeta u shqua si burimi më i cituar i lajmeve nga Kosova në mediet ndërkombëtare, ndërsa për shkak të raportimeve të veta për krimet e Serbisë në Kosovë, “Koha ditore” shpejt u bë edhe cak i sulmeve të pushtetit të Beogradit. Në këtë kohë “Koha ditore” kishte edhe edicionin për diasporë, që informonte shqiptarët në vendet e Europës Perëndimore, ndërsa në janar dhe shkurt të vitit 1999, në kohën e zhvillimit të negociatave për Kosovën në Rambouillet dhe më pas edhe në Paris, gazeta botonte edhe edicionin në gjuhën angleze, “KD Times”. Natën e nisjes së bombardimeve të NATO-s më 24 mars 1999, zyrat e gazetës u sulmuan nga policia serbe, u vra roja e gazetës, ndërsa shtypshkronja u dogj e tëra. Pjesa më e

madhe e redaktorëve dhe gazetarëve u detyrua të fshihet apo ta braktisnin vendin. Botimi i sërishëm i gazetës nisi më 26 prill 1999, kur një pjesë e gazetarëve, të mbledhur në Tetovë rreth kryeredaktorit të atëhershëm Baton Haxhiu, rinisën botimin me edicionin jashtë vendit, i cili shpërndahej falas në kampet e refugjatëve kosovarë. Pas luftës "Koha ditore" u kthye në selinë e saj në Prishtinë, prej ku rinis punën. Edhe në këtë kohë gazeta u shqua për raportimin kritik të fenomeneve të pasluftës. Në vitin 2004 botuese e gazetës u bë Flaka Surroi, ndërsa kryeredaktor Agron Bajrami. Nga viti 2011 ajo ndërroi formatin dhe dizajnin, ndërsa më 2013 edicioni i së dielës mori formatin e javores së dikurshme "Koha", me trajtime dhe përmbajtje tematike. Gazeta "Koha ditore" dhe gazetarët e saj janë nderuar me çmime dhe mirënjohje të shumta për gazetari profesionale dhe hulumtuese. (Artan Krasniqi)

GAZETA "KOSOVA SOT". Gazetë e përditshme informative, që botohet në Prishtinë që nga viti 1998. Themelues ishte Interpres Company me president Ruzhdi Kadriun dhe



kryeredaktore Margarita Kadriun. Përgatitjet për botimin e kësaj gazete filluan më 1997, kurse numri i parë doli më 12 shtator 1998, pas angazhimit të disa gazetarëve të rinj për një treg ndryshe të medias së shtypur. Gjatë luftës së vitit 1999, në kohën e bombardimeve të NATO-s, e gjithë infrastruktura e gazetës u rrënua nga ushtria dhe policia e Serbisë, kështu që pas qershorit të vitit 1999 botuesit iu desh të niste gjithçka nga e para. Gazeta "Kosova sot" ishte botimi i parë ditor në Kosovë, që u shqua me përmbajtje zhanrore tabloidësh, duke kombinuar në faqet e saj ngjarjet që ndodhin në Kosovë, rajon dhe në botë, të cilat paraqesin

interes për opinionin e gjerë të vendit, përfshirë edhe një sërë temash atraktive, që u përkasin interesimeve të shtresave të ndryshme sociale, arsimore dhe kulturore. Sondazhet e kanë radhitur gazetën "Kosova sot" ndër më të shiturat dhe më të lexuarat në periudhën pas vitit 1999. Rubrikat speciale dhe veçmas temat për zhvillimet më të reja në art, modë, teknologji etj., i kanë dhënë gazetës identitet më vete ndër mediet e Kosovës. Gazeta ka edhe portalin online, në të cilin publikohen lajmet për ngjarjet e ditës dhe shkrimet më të rëndësishme të gazetës. (Shaqir Foniqi)

GAZETA "KOSOVA" (1941-1944). Fletore politike, shoqërore, letrare, organ i Komitetit të Kosovës, themeluar në Tiranë. Dilte një herë në javë. Pjesërisht dilte edhe në gjuhën italiane. Numri i parë doli më 27 prill 1941. Pasqyronte programin e Komitetit Kosovar dhe qëllim kryesor kishte bashkimin e territoreve shqiptare në një shtet, ndërkohë që ai shtet ishte i pushtuar nga Italia fashiste. Gazeta shkruante për të drejtën natyrore të shqiptarëve për t'u bashkuar në një shtet, se Shqipëri ishte deri atje ku flitej gjuha shqipe, se "gjuha asht tapi e vendit". Duke ndjekur të dhënat statistikore e hartografike për popullsitë në Mbretërinë e Jugosllavisë sipas përkatësisë fetare e gjuhësore të vitit 1921, të botuara në vitin 1924, gazeta tërhoqi vijën për përkufizimin etnik të popullit shqiptar dhe të Shqipërisë Etnike. Gazeta Kosova e tetorit 1943 solli një shkrim të plotë të punimeve dhe të vendimeve të kuvendit themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Ndërkaq, më 1944 gazeta i bëri jehonë luftës së Kosovës përballë invazionit komunist dhe çetnik jugosllav, duke fuar shqiptarët në luftë për jetë a vdekje. Ajo e thërriste popullin shqiptar që ta kishte mendjen vetëm te shpëtimi i Kosovës, sikundër që "anmiqët tanë e kanë te pushtimi i Kosovës". Gazeta "Kosova" doli në 59 numra. Numri i saj i fundit doli në prill të vitit 1944. (Lush Cula)

GAZETA "LAJM EKSKLUZIVE". Gazetë e përditshme. Filloi botimin në shtator të vitit 2004. Ishte gazetë e formatit të madh, në model të gazetave të njohura botërore. Gazeta u financua nga biznesmeni Behgjet Pacolli. Stafin redaksional e përbënin disa emra të njohur të gazetarisë së Kosovës: Agim Mala, Rexhep Hoti, Qani Mehmedi, Halil Matoshi, Dukagjin Gorani etj. Brenda një kohe të

shkurtër gazeta arriti të bëhej e dyta për nga tirazhi dhe ushtroi ndikim në opinionin publik në Kosovë. Si "Lajm Ekskluzive" pati botime të veçanta: "Lajm Maqedoni" dhe "Lajm Europë", si dhe botimin në gjuhën angleze. Me botuesin e parë u botua rreth tri vjet, pastaj e ndryshoi pronarin dhe me format dhe përmbajtje të ndryshuar u botua edhe tri vjet të tjera, derisa e ndërpreu botimin e shtypur dhe kaloi në edicionin online. (Artan Krasniqi)

GAZETA "POPULLI" (1919-1920). Organ i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Botohej pjesërisht edhe në frëngjisht. Numri i parë doli më 18 janar 1919 në Shkodër, u botuan gjithsej 77 numra deri më 1 shtator 1920. Udhëheqësi dhe ideologu kryesor i kësaj gazete ishte Sali Nivica. Gazeta shprehte aspiratat dhe idealet e popullit, të përfaqësuar nga organizata politike e luftarake Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Një numër kopjesh të gazetës dërgoheshin në Francë, Itali, Zvicërr, SHBA, Turqi etj. Disa nga artikujt kryesorë të saj botoheshin në gjuhën frënge, sepse pikërisht nga francezët që ndodheshin në Shkodër kishte marrë lejen për botim. Gazeta synonte t'ua bënte me dije Fuqive të Mëdha kërkesat themelore të shqiptarëve dhe pretendimet e shteteve fqinje ndaj tyre. Ajo apelonte tek intelektualët që dijen dhe kulturën ta venin në shërbim të lëvizjes kombëtare. Gazeta "Populli" e demaskoi propagandën dhe demagogjinë e pushtuesve italianë si dhe politikën e qarqeve sunduese të Athinës ndaj Shqipërisë së Jugut. Edhe Konferenca e Paqes, që i zhvillonte punimet në Paris, ishte në qendër të vëmendjes së shkrimeve të saj. Përveç kësaj, pothuajse në çdo numër gazeta sillte nga një artikull mbi çështjet ekonomike, ku trajtoheshin nevojat për një bankë tregtare, një dhomë tregtie, domosdoshmëria për të siguruar qetësinë në Shqipëri dhe për t'i dhënë fund kaosit financiar. Në thirrjet drejtuar popullit, gazeta i ftonte masat që të përfaqonin vendimet e Kongresit të Lushnjës. Pas vrasjes së Sali Nivicës (1920) gazeta doli shumë rrallë. Dolën tre numra dyfletëshe dhe njëzet e tre numra njëfletëshe, derisa u mbyll përfundimisht më 1 shtator 1920. (Lush Culaj)

GAZETA "RADNIČKE NOVINE". Gazetë e pavarur serbe, me orientim të majtë, që kritikoi politikat qeveritare të Mbretërisë Jugosllave

ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Gazeta (Radničke novine - Gazetë e punëtorëve) filloi të botohet në Beograd në vitin 1897, por u ndalua për shkak të qëndrimeve politike. Filloi të dalë sërish më 1902, me kryeredaktor Dimitrije Tucoviqin. Nga viti 1903 deri në vitin 1919 ishte organ i Partisë Socialiste Serbe, ndërsa nga viti 1920 organ i Partisë (Socialiste) Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Edhe si organ i këtyre partive u ndalua, ngase kritikoi politikën serbomadhe të elitës monarkike serbe e jugosllave, e cila ushqente shovinizmin dhe militantizmin me synime të formimit të një Serbie të Madhe. Gazeta kritikoi dukurinë e përhapur rusofile serbe. Mbeti ndër gazetat e rralla serbe që kritikoi synimet pushtuese serbe ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë. Edhe në periudhën 1918-1941, si organ i PKJ-së u angazhua kundër shtypjes së shqiptarëve nga Mbretëria e Jugosllavisë. Gazeta pushoi së botuari në fillim të Luftës së Dytë Botërore. (Izber Hoti)

GAZETA "RILINDJA". Gazeta kryesore dhe më e madhja në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi. Numri i parë i "Rilindjes" doli më 12 shkurt të vitit 1945 në Prizren me një tirazh



5 mijë kopje, fillimisht si organ i Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar të Kosovës, e më vonë i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës. Numrat e parë të "Rilindjes" u shtypën në Shtypshkronjën Shtetërore në Prizren, një herë dhe dy herë në muaj, kurse nga 16 dhjetori i vitit 1946 redaksia transferohet në Prishtinë, ku u shtyp në Shtypshkronjën Krahinore të Frontit Popullor. Përveç një periudhe të shkurtër (3 nëntor 1950-14 janar të vitit 1951), kur u shtyp në Mitrovicë, u përgatit dhe doli rregullisht në Prishtinë. Këtu,

pasi ndërroi disa adresa, u vendos në objektin e ish-burgut, në rrugën "Zenel Salihu" nr. 4, afër Muzeut të tashëm të Kosovës, ku ndodhej edhe shtypshkronja "Milladin Popoviq", e cila më vonë edhe ajo merr emrin "Rilindja". Më 12 prill 1977 gazeta "Rilindja" filloi të shtypet në shtypshkronjën e vendosur në Pallatin e Shtypit. Një vit më vonë edhe redaksia e gazetës kaloi në Pallatin e Shtypit.

Më 1946 "Rilindja" dilte një herë në javë, nga 27 qershori i vitit 1948 dy herë në javë (të dielave e të enjteve), e prej 29 nëntorit të vitit 1958 çdo ditë, pos të dielave, kurse nga viti 1964, edhe të dielave. Numri i parë i "Rilindjes" u botua në katër faqe, më vonë, deri në vitin 1958, dilte në 12 faqe, e kur më 29 nëntor të atij viti u bë e përditshme fillimisht dilte në 16 faqe e të shtunave në 20, ndërsa pas vitit 1964 çdo ditë në 20 faqe dhe të shtunave 24 faqe. Në vitet '70 dhe '80 botohej çdo ditë në 24 faqe, kurse të shtunave në 32 faqe. Numrat e ditëve të festave dilnin deri në 100 faqe. Ndër vite, tirazhi mesatar ditor u soll nga 5-10 mijë e deri në 70 mijë kopje, sa ishte mesatarja gjatë vitit 1990 deri më 7 gusht, kur u ndalua nga Serbia. Tirazhin më të madh "Rilindja" e shënoi me numrin e Vitit të Ri 1985, kur u botua në 250 mijë kopje. Shpërndahej në të gjitha hapësirat e banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi, edhe në kryeqytetet e republikave të ish-Jugosllavisë dhe vendbanime të tjera ku kishte parapagues, në Armatën Popullore të Jugosllavisë si dhe në shtetet e Europës Perëndimore dhe SHBA. Gjatë viteve ajo ruajti një fizionomi standarde me përmbajtje nga politika e jashtme, politika e brendshme, kultura, arsimit e shkencat, ekonomia, bujqësia, sporti, argëtimi. Ndër shtojcat javore kishte atë për kulturë, art e shkencë, që botohej të shtunave; shtojcën e sportit, të hënave; të martave shtojca për fëmijë; të premtëve programi i radiotelevizionit; pastaj shtojca për gra që dilte të enjteve; e humorit të dielën. Kishte rubrikat standarde të komenteve, të kronikave, të karikaturës aktuale, letrat e lexuesve, fjalëkryqin, këndin enciklopedik, fejttonin, romanin etj. Të dielën botohej faqja e reportazheve, kurse faqet e reklamës, shpalljeve dhe përkujtimeve ishin të përditshme. Më 5 korrik të vitit 1990, me vendim të veçantë, Serbia e ndaloi botimin e "Rilindjes", por redaksia e saj e shpërfilli urdhrin dhe ajo doli deri më 7 gusht të atij viti, kur forcërisht u ndal së botuari. Nga kjo datë

vazhdoi të përgatitej nga i njëjti ekip redaktues, me të njëjtit gazetarë dhe me fizionominë e përmbajtjen tradicionale, por me emra të ndryshëm: "Zëri", "Bujku", "Fjala", BAT, GEP ("Gazeta e Pionierit") e "Shkëndija", në mënyrë që nga 30 dhjetori 1990 të dalë çdo ditë me emrin "Bujku". Nga 22 shkurti i vitit 1999, kur u dëbua nga ambientet e punës në Pallatin e Shtypit, me arsyetimin se nuk ishte luajale ndaj Beogradit dhe nuk njihnte autoritetin ndërmarrjes serbe "Panorama", të krijuar nga Beogradi, rinisi të botohet me emrin "Rilindja", gjithnjë deri më 23 mars, kur u ndërpre botimi për shkak të fillimit të bombardimeve të NATO-s dhe të pamundësisë së përgatitjes e të shtypjes së saj brenda Kosovës.

Më 24 maj 1993 punonjësit e "Rilindjes" mbajtën një grevë urie 257 orësh me kërkesat për lirinë e shtypit, e cila nuk rezultoi me ndonjë përmirësim të gjendjes, por që pati jehonë në botë. Me të njëjtin emër "Rilindja" u botua në Zvicër (në Zofingen) nga 7 maji i vitit 1992, kurse në Tiranë nga 18 prilli i vitit 1993 dhe deri në përfundim të luftës, në qershor të vitit 1999. Nga tre gazetarë e redaktorët, që përgatitën numrin e parë të "Rilindjes", Esat Mekuli, Kolë Shiroka e Sokol Dobroshti, numri i tyre në vitet kur nisi të botohej çdo ditë u rrit në mbi 30, për të arritur deri në rreth 170 veta në vitin 1990. "Rilindja" kishte korrespondentë të përhershëm në të gjitha qendrat komunale të Kosovës, në qytetet kryesore nga dy, pastaj në Beograd, Shkup, Preshevë, Ulqin, Dibër, Tetovë, ndërsa të herëpërhershëm në Zagreb, Sarajevë, Gostivar, Strugë e Kumanovë. Në vitin 1974 "Rilindja" caktoi korrespondent të përhershëm në Bejrut, në Bon më 1976 dhe në Nju-Jork më 1978. "Rilindja" aplikoi me konsekuencë standardin e gjuhës shqipe, kurse nga 12 shkurti i vitit 1970 zbatoi gjuhën e unifikuar standarde shqipe. Me të përfunduar lufta, në qershor të vitit 1999, "Rilindja" rinisi të botohej dhe, me disa ndërprerje, vazhdoi deri në vitin 2002. Pas kësaj kohe doli vetëm ndonjë numër në raste të veçanta. (Zenun Çelaj)

GAZETA "SHKUPI". Gazetë e themeluar me vendimin e Kongresit të Dytë të Manastirit më 2 prill të vitit 1910. U botua në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës, në Shkup. Numri i parë doli me 29 gusht 1911, ndërsa numri fundit më 3 tetor 1912, gjithsej 34 numra. Gazeta dilte një herë në javë, e ndonjëherë edhe një herë në dy



GAZETA "SHKUPI", 1911

javë. Dy faqet e para të gazetës ishin në gjuhën shqipe me alfabetin e Shoqatës "Bashkimi", kurse dy faqet e fundit në turqisht (osmanisht) me shkrim arab. Kryeredaktor i saj ishte Jashar Erebara. Tekstet e publikuara në gjuhën shqipe kanë përmbajtje politike në favor të lëvizjes patriotike shqiptare. (Skënder Asani)

GAZETA "TAN". Gazetë javore në gjuhën turke, që botohet në Prishtinë nga viti 1969. Si gazetë u themelua nga Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, që më pas u shndërrua në Ndërmarrjen Gazetare Botuese (NGB) "Tan". Përveç se ka siguruar informim për lexuesit në gjuhën turke, NGB "Tan" ka ndikuar edhe në zhvillimin e arsimit, të letërsisë, të artit dhe të kulturës të kombësisë turke në Kosovë dhe më gjerë. Gazeta "Tan" për një kohë ka qenë gazetë e lexuesve në gjuhën turke në mbarë hapësirën e ish-Jugosllavisë. Një numër kopjesh të gazetës u dërgoheshin abonentëve në Republikën e Turqisë, si dhe institucioneve përkatëse në vende të ndryshme, kryesisht hulumtuesve të fushave të ndryshme, turkologëve etj. Përveç gazetës javore, NGB "Tan" kishte edhe edicionin e botimeve, ku janë botuar rreth 160 tituj të librave (romane, poezi, drama, antologji) të autorëve që shkruanin në gjuhën turke, por edhe vepra të përkthyer nga gjuha shqipe, boshnjake, maqedonase, serbe etj. NGB "Tan" deri në ditët e sotme ka mbetur i vetmi institucion profesional me veçoritë e personit juridik dhe me atributet e "ndërmarrjes së interesit të veçantë", si shfrytëzues permanent i buxhetit të Kosovës. (Agnesa Rashiti-Gllboderi)

GAZETA "TRIBUNA". Gazetë e përditshme. Nisi të botohej si "Tribuna shqiptare" në vitin

2009 nga gazetari Rexhep Hoti, për të vazhduar pastaj me emrin "Gazeta Tribuna". Mblodhi rreth vetes gazetarë të rinj. Nga marsi i vitit 2015, në kuadër të "Tribuna Media Grup" u hap televizioni "Tribuna Channel", që, së bashku me "Gazetën Tribuna", kanë mbi 140 të punësuar, me një sërë projektesh të reja mediale. (Artan Krasniqi)

GAZETA "ZËRI". Gazetë ditore, që nisi botimin në fillim të vitit 2000. U konsiderua si pasardhëse e revistës javore "Zëri", apo "Zëri i rinisë" që u botua më herët në Prishtinë. Disa nga gazetarët që më parë kishin punuar në javoren "Zëri", së bashku me një numër gazetarësh të rinj dhe me disa syresh që kishin punuar në gazetën "Rilindja", pas përfundimit të luftës u organizuan dhe në fund të vitit 1999 nxorën numrin e parë të kësaj gazete ditore, me drejtor Blerim Shalën dhe me kryeredaktor Bardh Hamzën. Ata krijuan profilin informativ, politik dhe kulturor të gazetës, duke hedhur në qarkullim një gazetë që u profilizua shpejt në tregun medial të Kosovës. Gazeta shquhej për gazetari profesionale, objektive dhe të balancuar. Një plejadë e tërë gazetarësh të rinj kanë bërë emër dhe kanë krijuar profilin e tyre profesional në rubrikat e kësaj gazete. Së fundi, gazeta "Zëri", përveç edicionit të shtypur ditor, editohet edhe në botimin online. (Bajrush Morina)

GAZETA E MBRËMJES "INFORMATORI". Gazetë e Qendrës për Informim të Kosovës (QIK), e cila vepronte si zyrë për Informim e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ishte gazeta e parë e mbrëmjes dhe ende e vetmja në historinë e medieve në gjuhën shqipe. Kryeredaktor i gazetës ishte Enver Maloku, njëkohësisht shef i QIK-ut. Gazeta botonte lajme dhe tema që ishin të lidhura me qytetin e Prishtinës, por botoheshin edhe informacione dhe artikuj që kishin të bënin me zhvillimet kryesore politike dhe sociale në Kosovë dhe diasporë. Gazeta u gjet nën trysinë e madhe të policisë serbe, e cila krijonte pengesa për shtypjen dhe shpërndarjen e saj. Meqë nuk kishte një rrjet të shpërndarjes, dërgimi i saj deri te lexuesit u bë gjithnjë e më i vështirë dhe ajo pas disa muajsh ndaloi së shtypuri, ndërsa kryeredaktori i saj, Enver Maloku, u vra në një atentat disa muaj më vonë. (Ibrahim Berisha)

GAZETAT E NDËRMARRJEVE. Gazeta të ndërmarrjeve të mëdha, të cilat u botuan në

periudhën e autonomisë së Kosovës. Qëllimi i botimit të tyre ishte informimi i punëtorëve me proceset kryesore që zhvilloheshin në fushën e prodhimit dhe për të afirmuar rezultatet e punës në këto ndërmarrje. Të gjitha ndërmarrjet e mëdha në Kosovë botonin gazetata e tyre javore, dyjavore apo njëmuore, varësisht nga numri i punëtorëve. Këto gazeta ndryshe quheshin “gazetat e kolektiveve”. Gazetat dilnin në gjuhën shqipe dhe atë serbokroate, disa edhe në gjuhën turke. Gazeta me tirazh më të madh “Trepça”, që botohej në gjuhën shqipe dhe serbokroate, informonte punëtorët për punën që bëhej në miniera dhe fabrikat e këtij gjiganti minerar-industrial. Gazetë me tirazh po kaq të madh ishte edhe gazeta “Kosova”, botim i “Elektroekonomisë” së Kosovës. Pastaj vinin: “Agrokosova”, botim i Kombinati Bujqësor-Industrial po me këtë emër; “Ramiz Sadiku”, botim i ndërmarrjes ndërtimore; pastaj gazeta “Ulpiana”, “Emin Duraku” (gazetë e fabrikës së tekstilit në Gjakovë), “Rilindja” (gazetë e Ndërmarrjes Grafike, Botuese, Tregtare po me këtë emër); “Elektrokosova” (botim i Ndërmarrja për Shpërndarje të Energjisë); pastaj “Ndërtimi”, “Energoinvest-Energomontimi” etj. (Ibrahim Berisha)

GAZI Mehmet Pashë (?-1551). Pushtetar i lartë, komandant ushtarak dhe themelues vakëfesh. Ishte pinjoll i familjes së Jahja Pashës. Që në rini njihej me epitetin “çelebi”. Si dhe gjyshi i tij, Jahja Pasha (vd. 1507) dhe i ati Bali Pasha (vd. 1531), edhe Gazi Mehmet Pasha u shqua si komandant ushtarak i repartit të akinxhinjve. Ka qenë sanxhakbej i disa sanxhaqeve të Rumelisë: i Vidinit, Smederevës, Beogradit etj. Gjatë viteve 1543-1548 ishte në pozitën e bejlerbeut të Budimit (Hungari). Në vitin 1537, duke qenë si sanxhakbej i Qystendilit, ndërtoi në Prizren xhaminë, medresenë dhe hamamin për burra dhe gra, që ekzistojnë edhe sot. Në Leshan të Suharekës, në fshatin e të parëve të tij, ngriti një xhami, mejtepin dhe dy mullinj. Pas vdekjes së tij, sipas amanetit që kishte lënë, u ngritën në Prizren një imaret afër xhamisë së tij dhe një karvansaraj me pesë dhoma. (Nehat Krasniqi)

GAZIDEDA Kajmak (1942-2003). Mjek, infektolog, profesor universiteti. Lindi në Brezhdan të Shqipërisë, arsimimin bazë e mori në Tetovë, ndërsa u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1970). Pas diplomimit u punësua



KAJMAK GAZIDEDA

në Klinikën Infektive të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe më vonë u zgjodh asistent i lëndës sëmundjet infektive. Specializimin për infektologji e filloi në Prishtinë dhe e kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit.

Mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1979) dhe më pas mori titujt përkatës, përfshirë edhe titullin e profesorit ordinar në lëndën sëmundjet infektive. Në vitin 1991 u largua nga puna dhe në kushtet e organizimit të arsimit paralel u angazhua në mësimdhënie dhe drejtoi disa magjistratura e doktoratura. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume, brenda dhe jashtë vendit, si dhe publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale si autor dhe bashkautor. Vdiq në vendin e punës në vitin 2003. Me emrin e tij lidhet zhvillimi i Klinikës së Infektologjisë dhe i infektologjisë kosovare në përgjithësi. (Salih Ahmeti)

GAZIFIKIMI I QYMYRIT, OBILIQ. I ndërtuar në vitin 1970, gazifikimi prodhoi gaz gjeneratorik sipas teknologjisë gjermane “Lurgi”. Të gjitha analizat e bëra tregojnë se gazifikimi i qymyrit të terur nuk është trajtuar në mënyrë përkatëse, sepse që nga fillimi kishte vështirësi në proces. Në impiantin e gazifikimit në Obilic janë të instaluar 6 gjeneratorë të tipit “Lurgi”, çdo gjenerator prodhonte 18,000 m³/h gaz gjeneratorik të papërpunuar, që do të thotë se rendimenti i 5 gjeneratorëve është 90,000 m³/h. Si mjet i gazifikimit përdoret avulli i ujit teknologjik nga kaldajat e ngrohtores, me shtypje prej 32 bar dhe temperaturë 350°C, i cili me oksigjen (96%) dhe shtypje 28 bar përzihet në raport 7:1, varësisht nga temperatura e shtrirjes në fundin e gjeneratorit. Gazi gjeneratorik përdoret si lëndë djegëse, sepse posedon vlerë të lartë termike. Nga gazi gjeneratorik është përftuar hidrogjeni dhe gazi termik. Përveç procesit të gazifikimit, në këtë impiant bën pjesë edhe reparti për shpërbërjen e ajrit, ku përftohen azoti dhe oksigjeni. Gazet e ndara, hidrogjeni dhe azoti, janë shfrytëzuar si lëndë e para në sintezën e amoniakut, ndërsa amoniaku i përftuar shërbente si lëndë e parë për prodhimin e acidit nitrik. Këto lëndë të

para kanë shërbyer për prodhimin e plehrave azotike. Objektet e gazifikimit janë konservuar dhe nuk shfrytëzohen për prodhim. (Shefqet Rashani)

GECA Ahmet (1943-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet i përfundoi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Beogradit (1969). Po aty i kreu edhe studimet pasuniversitare, ndërsa doktoroi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1987). Pas diplomimit filloi punën në Fabrikën e Autopjesëve në Pejë,



AHMET GECA

kurse nga viti 1972 deri në pensionim punoi në Fakultetin e Makinerisë të UP-së. Ishte titullar i lëndëve mekanika, teoria e lëkundjeve dhe i lëndëve nga siguria në komunikacion. Ushtri funksione drejtuese në fakultet dhe në UP (dekan dhe prorektor). Ka një veprimtari të gjerë botimesh: 6 tekste mësimore dhe një sërë punimesh shkencore të botuara në shtypin shkencor. Për nevojat e ekonomisë kreu disa projekte nga fusha e makinerisë dhe një numër ekspertizash nga komunikacioni rrugor. Mori pjesë në shumë seminare, trajnime dhe bashkëpunime me institucione hulumtuese, shkencore dhe arsimore brenda dhe jashtë vendit. (Xhevat Perjuci)

GECAJ Abdulla (1942-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Llaushë të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet për biologji në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (1967). Ka mbajtur mësim në Shkollën Normale në Mitrovicë dhe në Gjymnazin “Ramiz Sadiku” në Skënderaj. Në vitin 1972 zgjidhet asistent në FSHMN, në seksionin e biologjisë. Tezën e magjistraturës dhe të doktoratës i mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit. Ka qëndruar për specializim në Institutin e Higjienës në Pragë, bursist i Fondacionit WHO. Në vitin 2004 mori titullin e profesorit ordinar. Ka publikuar disa punime shkencore dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore dhe profesionale. Është autor i një praktikumi

për studentë dhe i disa teksteve për shkollë të mesme. Ka qenë koordinatör i projekteve shkencore dhe ka kryer detyra organizative në institucionin ku punonte. (Behxhet Mustafa)


GECI Jetulla (1954-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Llaushë të komunës së Skënderajt. Në periudhën 1980-1986 punoi në ndërmarrjen “Përparimi”. Ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1989 në Skënderaj dhe më pas pjesëmarrës në lëvizjen për pajtimin e gjaqeve. Më 30 dhjetor 1991 ishte pjesëmarrës në betejën kundër forcave serbe, të cilat sulmuan familjen Jashari. Mori pjesë në disa sulme ndaj forcave policore serbe, si në stacionin policor në Runik të Skënderajt dhe në betejën e parë frontale të UÇK-së në Klysyre (26 nëntor 1997). Gjatë luftës ishte komandant i batalionit special në rajonin e Drenicës dhe më pas u emërua komandant i Brigadës 112 “Arben Haliti” të Zonës Operative të Drenicës. Mori pjesë në betejën e Gllarevës, në Kodër të Radishevës, Përrua të Keq etj. U plagos në betejën e Përronit të Dreçollit më 15 mars 1999. Pas luftës mbajti pozita udhëheqëse në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. (Sabit Sylja)

GECI Osman (Shaban) (1943-1998). Luftëtar për lirinë e Kosovës, bashkëluftar i Adem Jasharit, dëshmor. Lindi në Llaushë. Familja Geci ishte në marrëdhënie miqësie me familjen e Jasharajve të Prekazit të Poshtëm. Në vitin 1989, kur më 30 dhjetor policia serbe rrethoi Jasharajt, O. Geci së bashku me vëllezërit e tij u shkoi në ndihmë nipave në Prekazin e Poshtëm. Nga ajo kohë dajë Osmani nuk u nda nga nipat e tij, Ademi dhe Hamëza. Së bashku me nipat dhe ushtarët e tjerë të UÇK-së mori pjesë edhe në luftimet e 25/26 nëntorit të zhvilluara në Vojnik e Rezallë të Re. Edhe në ditët e luftës së lavdishme të Jasharajve, O. Geci ishte në kullën e nipave. Aty ra heroikisht më 5 mars 1998. (Jakup Krasniqi)

GECI Sabit (1958-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Lindi në fshatin Llaushë të komunës së Skënderajt. Më 1996 u inkuadrua në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke ndërmarrë një sërë aksionesh ndaj forcave serbe, si në Runik të Skënderajt në fillim të vitit 1997. Më 28 shkurt 1998 mori

pjesë në betejën e Likoshanit. Në këtë betejë mori plagë të rënda. Ende pa u shëruar tërësisht, filloi aksionet e reja ndaj forcave serbe. Mori pjesë në luftimet e zhvilluara në grykën e Llapushnikut, në betejën e Bellaqecit, të Llaushës, si dhe në shumë beteja të tjera. Ndërkohë, gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua, prandaj u detyrua të shkojë për shërim në Shqipëri, pastaj në Turqi dhe Slloveni. Pas shërimit të pjesshëm u kthye në Shqipëri, duke marrë detyrën për organizimin e rekrutëve të rinj dhe ndërlidhjen e oficerëve të Shqipërisë me oficerët e UÇK-së. (Sabit Sylja)

GECI Shaban (1935-2011). Mjek, internist, hematolog, profesor universiteti. Lindi në Rogoçicë të Kamenicës, ku mori arsimin fillor, ndërsa shkollën e mesmen e kreu në Prishtinë.



SHABAN GECI

U diplomua në katedrën e albanologjisë në Universitetin e Beogradit (1960). Pas mbarimit të studimeve u emërua mësues në Hogosht të Kamenicës, por i ndjekur nga organet e sigurimit u detyrua të largohet dhe u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1962). Pas diplomimit u punësua në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës. Me themelimin e Fakultetit të Mjekësisë kaloi në Klinikën Interne. Specializoi për hematologji, të cilën e kreu në Zagreb, duke u bërë hematologu i parë kosovar (1972). Vijoi studimet pasuniversitare në Zagreb, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1978). Ndërkohë, më 1972 u emërua asistent, më pas docent, më 1985 profesor inordinar dhe më 1990 mori titullin profesor ordinar i lëndës mjekësi interne. Një periudhë të gjatë kohore ishte kryeshëf i repartit hematologjik të Klinikës Interne. Në vitin 1990 u përjashtua me dhunë nga puna. Ishte shëf i katedrës për sëmundje të brendshme në Fakultetin e Mjekësisë të organizuar në kushte të jashtëzakonshme. Gjatë kësaj kohe në klinikën e tij private organizoi ushtrimet praktike për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, për mjekët stazhistë dhe specialistët. Mori pjesë në shumë simpoziume e kongrese brenda dhe jashtë vendit si dhe publikoi shumë punime profesionale-shkencore. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve. (Ahmet Brovina)

GECI Xhevahir (1967-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Llaushë të Skënderajt. Ishte njëri ndër bashkëthemeluesit e grupit të parë të luftës çlirimtare në Kosovë që nga vitit 1991 dhe pjesëmarrës i luftimeve më 30 dhjetor 1991, kur forcat serbe sulmuan familjen Jashari. Mori pjesë në sulmin kundër forcave policore serbe në Skënderaj më 7 korrik 1992. Gjatë viteve 1992-1997 punoi për sigurimin e armatimit dhe për përgatitjen ushtarake të të rinjve. Mori pjesë në betejën e parë frontale ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe në Klysyre (26 nëntor 1997) dhe ishte pjesëmarrës në luftimet e UÇK-së në Likoshan dhe Qirez (28 shkurt 1998), në betejën e Llaushës, të Rahovecit, të Bellaqecit dhe të Dubofcit në mars të vitit 1999. Ishte anëtar i Shtabit të Zonës Operative të Drenicës, komandant i batalionit të parë në Brigadën 112 "Arben Haliti" dhe komandant për komunikim. Pas luftës kreu detyra me rëndësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Sabit Sylja)

GECI Zekë (1954-). Gazetar. Lindi në Llaushë të Skënderajt. Filloren e kreu në fshatin e lindjes, të mesmen në Skënderaj, ndërsa Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Zagrebit. Më 1985 u punësua në të përditshmen "Rilindja" në Prishtinë. Deri në vitin 1998 në këtë gazetë shkroi lajme, artikuj, komente e analiza mbi zhvillimet politike në vend. Më 1998 emigroi në Zvicër, ku vazhdon të jetojë. (Zenun Çelaj)

GEDIK Ahmet Pasha (?-1482). Personalitetet i shquar shqiptar në Perandorinë Osmane të shek. XV. Hyri në oborrin e sulltan Muratit II (1421-1451) nga radhët e icoçglanëve. Gjatë sundimit të sulltan Mehmetit II (1451-1481) ishte bejlerbe i rajoneve të Rumit dhe Anadollit. Në vitin 1474 sulltani e emëroi vezir të madh (kryeministër) të Perandorisë. Në këtë post qëndroi deri në vitin 1477 kur u shkarkua dhe u burgos, pasi refuzoi të komandonte ekspeditën e madhe osmane për pushtimin e qytetit të Shkodrës, të planifikuar për atë vit. Një vit më vonë u fal nga sulltani dhe u emërua në postet e larta të komandantit të flotës detare osmane dhe të qeveritarit të sanxhakut të Vlorës. Duke qenë në këto funksione, ai pushtoi ishujt e detit Jon: Kefaloninë, Zantën dhe Shën Maurën. Me urdhër të Mehmetit II,

në krye të forcave osmane për herë të parë kaloi në bregdetin italian dhe në gusht të vitit 1480 pushtoi Otranton. Kjo ngjarje shkaktoi alarm në qarqet politike të Europës së asaj kohe. Por vdekja e papritur e sulltan Mehmetit II më 1481 e detyroi pasardhësin e tij, Bajazitin II, ta urdhërojë Gedik Ahmet Pashën për tërheqjen e trupave osmane nga Italia. Duke qenë se shihej gjithnjë me dyshim nga sulltani i ri, Gedik Ahmet Pasha u ekzekutua me urdhër të tij në vitin 1482 dhe u varros në Edrene. (Ferit Duka)

GEGA Xhevat (1934-2017). Mësimdhënës universiteti, studiues i letërsisë. Lindi në Strugë, ku kreu edhe shkollën fillore, normalen e kreu në Shkup, përkatësisht në Tetovë. Studimet për



XHEVAT GEGA

Normalen e Shkupit. Në vitet 1969-1974 ishte mësimdhënës në Akademinë Pedagogjike në Shkup, nga viti 1974 edhe bashkëpunëtor në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik të Shkupit. Krahas punës mësimore, Xhveti Gega u mor edhe me veprimtari të tjera kulturore e shkencore, si dhe me hartimin e teksteve shkollore. Ka botuar një sërë studimesh shkencore-profesionale dhe është autor i shumë veprave letrare: “Poezia origjinale e Fan Nolit dhe gjeneza e saj politike” (1965), “Çështjet kryesore në lidhje me hulumtimet e letërsisë të kombësisë shqiptare në Republikën e Maqedonisë” (1988) etj. (Fadbi Osmani)

GEGAJ Athanas (1904-1988). Historian, publicist, meshtar. Lindi në Triesh të Malësisë. Emri i tij i vërtetë ishte Lucë Gegaj, ndërsa u bë i njohur me emrin kishtar Athanas. Shkollimin e mesëm e ndoqi në gjimnazin françeskan të Shkodrës, ndërsaq studimet për teologji i vazhdoi në Itali dhe Belgjikë. Në vitin 1937 u bë meshtar në Triesh dhe Tuz. Para Luftës së Dytë Botërore punoi për një kohë si mësues në kolegjin françeskan të Shkodrës, ku ligjëronte lëndën e historisë. Ishte njohës i mirë i gjuhëve

klasike. Për shkak të kundërshtimit të tij ndaj pushtimit fashist të Shqipërisë që internuar dhe nuk u kthye më në atdhe. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si sekretar në oborrin e mbretit Zog në mërgim, më pastaj u vendos në Boston, ku Fan S. Noli e emëroi sekretar të përgjithshëm të shoqërisë “Vatra”. Në periudhën 1967-1971 punoi në gazetën “Dielli”. Ditët e pleqërisë i kaloi në Santa Monika të Kalifornisë, ku vdiq pa pasur të drejtë kthimi në atdhe. Fusha e interesimit të tij ishte kryesisht historia mesjetare shqiptare, për të cilën botoi shumë artikuj në shtypin e huaj. Vepra e tij kryesore është njëherësh edhe punimi tij i doktoratës të mbrojtur në Universitetin e Louvenit në Belgjikë: “Shqipëria dhe invazioni osman në shek. XV”, botuar në Paris në 1937. Pas viteve ’90 vepra u botua edhe në shqip me titullin “Shqipëria dhe Gjergj Kastrioti-Skenderbeu 1405-1468” (2003). (Muhamet Mala)

GEGA-MUSA Leontina (1963-). Studiuese e folklorit. Lindi në Shkup, ku mori arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Shkupit (1985). Studimet pasuniversitare i ndoqi në Universitetin e Prishtinës, ku mbrojti tezën e doktoratës nga fusha e shkencave filologjike (2009). Punoi si asistente në Institutin e Folklorit “Marko Cepenkov” në Shkup deri në vitin 1989. Nga viti 1990 punon në Institutin Albanologjik të Prishtinës si këshilltare shkencore dhe përgjegjëse e degës së folklorit. Ka marrë pjesë me kumtesa për folklorin shqiptar në tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar monografitë studimore “Përkimet e letërsisë gojore me poezinë e shkruar për fëmijë të R. Hoxhës, V. Kikajt, R. Kukajt” (2004) dhe “Poetika e gjëgjëzës” (2009), si edhe përmbledhjen e studimeve “Refleksione folkloristike” (2011). Ka botuar edhe një sërë studimesh e recensionesh nga fusha e letërsisë gojore dhe të asaj krahasimtare me letërsinë gojore të rajonit dhe më gjerë. (Arbnora Dushi)

GEGIZMAT. Fjalë dhe struktura gramatikore të gegërishtes, që përfshihen në idioma të tjera. Veçori kryesore të gegërishtes janë mungesa e rotacizmit, togu zanor *ue*, pjesorja e shkurtuar ose me *ue*, paskajorja, hundorësia e zanoreve, format e futurit edhe me kam + paskajore e kështu me radhë. Gegizma mund

të konsiderohen fjalët me togun vokalik *ue* në formimet prapashtesore: punueshëm, mësues, punues, që janë përfshirë në shqipen standarde, sikur edhe format e paskajores (te domethënë, domethënëse) e kështu me radhë, sikur edhe emri vetvetor: *vet*. Gegizma mund të konsiderohen edhe disa fjalë që Nikollë Keta, arbëresh, i përdor, pasi i ka vjelë nga Budi. (Imri Badallaj)

GEGNISHTJA LETRARE. Varietet letrar i shqipes i shkruar qysh në shek. XV me dokumentin e njohur si Formula e pagëzimit (1462), i pasuar nga dokumenti tjetër i njohur si Fjalorthi i Arnold von Harfit (1497). Në shek. XVI-XVII u zhvillua një gegnishte letrare me një letërsi kryesisht fetare, por edhe me tematikë jofetare nga Buzuku (1555), Budi (1618-1621), Bardhi (1635, 1636) dhe Bogdani (1685). E shkruar me një alfabet mjaft homogjen, kryesisht me shkronja latine, por edhe me shkronja të posaçme dhe me një normë drejtshkrimore mjaft të konsoliduar, që krijoi një traditë përdorimi në Shqipërinë e Veriut deri në fillim të shek. XX, ajo shpesh paraqet veçori mbidialektore në shkallën që filologët e kanë të vështirë të identifikojnë të gjitha elementet specifike të idiomave të tyre natyrore. Ajo, madje, jo rrallë është parë si gegnishte me prirje koineizuese brenda gegnishtes (Bogdani). Në shek. XVIII tradita e shkrimit të gegnishtes letrare u pakësua ndjeshëm dhe njihet vetëm përmes materialeve të Kuvendit të Arbënit (1703) të shkruara për herë të parë me një gjuhë të stilit administrativo-juridik, përmes gramatikës së parë shqipe të F. M. Da Leçes (1716), përmes gramatikës së Grotaferratës (e shkruar më 1710 dhe e botuar më 1982), si dhe përmes katekizmit (1743) të Gjon N. Kazazit (geg. verilindore), por edhe përmes dorëshkrimeve të Anonimit të Elbasanit dhe të Dhaskal Todhrit (elbaskanishte), që përdorën alfabetë të veçanta të mbështetura në alfabetin glagolik. Kjo traditë u zhvillua shumë sidomos në shek. XIX-XX me një variant rreth Shkodrës (shkodranishte letrare, ndonjëherë asimilohet në gegnishte letrare) dhe më vonë me një tjetër variant rreth Elbasanit (gegnishte e mesme letrare). Kjo e fundit, e zhvilluar sipas parimeve të Komisisë Letrare të Shkodrës dhe e pasuruar me raporte të shumta nga variantet e tjera geqe, sidomos të shkodranishtes, ka qenë gjuhë zyrtare e Shqipërisë në periudhën 1923-1945.

Në pjesën e dytë të shek. XX zhvillohet një gegnishte letrare edhe në Kosovë, kryesisht e mbështetur në traditën e elbaskanishtes, por me ndikime jo të vogla të shkodranishtes dhe me tipare kosovare. Në këtë periudhë gegnishten letrare e kultivuan shkrimtarë, si L. Gurakuqi, F. Shiroka, N. Mjeda, P. Vasa, Z. Jubani, Gj. Fishta, P. Doçi, Migjeni, E. Koliqi, M. Camaj, A. Pashku, A. Shkreli etj. Nga viti 1972 gegnishtja letrare përdoret vetëm në letërsi dhe në komunikim të përditshëm gojor. Kohët e fundit ka një ringjallje të përdorimit të saj në medime të shkruara dhe elektronike. (Shkumbin Munishi)

GEGNISHTJA. Dialekti gegë ose dialekti i Veriut është emërtim për njërin nga dy dialektet e shqipes që flitet në tërë Shqipërinë në veri të lumit Shkumbin, në Republikën e Kosovës, në Mal të Zi, në Bujanoc, në Preshevë, në Medvegjë, në Sanxhak, në tërë Maqedoninë Perëndimore, pos Prespës, Ohrit dhe disa fshatrave të Strugës dhe në fshatin Arbanas (Arbnesh) të Zarës në Kroaci. Gegnishtja ka dy nëndialekte: veriore dhe jugore, që gjeografikisht ndahen te lumi i Matit. Nëndialekti verior ndahet në dy grupe të folmesh: verilindore dhe veriperëndimore e, po ashtu, edhe nëndialekti jugor në dy grupe të folmesh: grupi qendror dhe i Shqipërisë së Mesme. Gegnishtja nuk ka rotacizëm (*zâni*), ka zanore hundore (*vëna*) dhe gjatësi funksionale zanoresh (*pla:k - plak*), ka *-â-* të theksuar (*bâj*) aty ku toskërishtja ka *-ë-* (*běj*), ka grupin nistor *vo-* (*vorr*), togun zanor *ue* (*grue*), ka paskajoren *me punue*, forma të mbipërbëra për të shkruarën (*kam/kisha pas shkue*), mbiemra prejfoljorë me modalitet të mundësisë me *-shëm* (*i punueshëm*), pronorë vetvetorë (*i vet*), të pakryer sigmatike (*mbyllsha*), pjesore pa mbaresa (*li:dh, ha:p, la; punue*), ka mbaresë shumësi *-a* (*doktora*) aty ku toskërishtja ka *-ë*, të ardhme me modalitet domosdoje të tipit *kam + me punue* etj.; ka një leksik të pasur, shumë fjalë të cilat nuk janë përfshirë në shqipen standarde. Është e shkruar qysh në shek. XV. Dokumentet e para dhe librat më të vjetër të shqipes janë shkruar në këtë dialekt, si: Formula e pagëzimit (1462) e Pal Engjëllit, Fjalorthi i Arnold von Harfit (1497), libri i parë shqip "Meshari" i Gjon Buzukut (1555), veprat e Pjetër Budit, të Frang Bardhit, "Çeta e profetëve" e Pjetër Bogdani etj. Gegnishtja letrare ka qenë gjuhë zyrtare në Shqipëri

para Luftës së Dytë Botërore dhe në Kosovë deri më 1968. (Shkumbin Munishi)

GEJZERI I MADH DHE I VOGËL. Burime termominerale në pjesën e epërme të pellgut të lumit Jabllanica, në lokalitetin e Banjës së Sijarinës (Medvegjë). Janë krijuar në mënyrë artificiale (me shpim), andaj nuk janë gejzere natyrore. Burimi “Gejzeri i madh” është krijuar me shpime në vitin 1954. Nga ky burim del uji në lartësi prej 6-8 m, temperatura e të cilit është 71°C. Dalja e ujit përcillet me avull dhe gazra, ndërsa prurja është rreth 3 l/sek. Burimi “Gejzeri i vogël” ka filluar të dalë nga pusi i shpuar në vitin 1953. Pas maksimumit të erupsionit, pason tërheqja e shpejtë e ujit në pus. Erupsioni nga momenti i daljes së ujit prej pusit e deri te tërheqja zgjat 2.5 minuta. Këto janë vetëm dy nga shumë burime të ujërave termominerale të Banjës së Sijarinës. (Arsim Ejupi)

GELCIÇ Gjuzep (Giuseppe Gelcich) (1849-1925). Historian, arkivist, paleograf. Lindi në Kotorr të Malit të Zi. Studimet për histori dhe gjeografi i përfundoi në Fakultetin e Filozofisë në Grac. Ishte profesor i Shkollës së Detarisë në Dubrovnik dhe profesor dhe drejtor i Akademisë Detare Tregtare në Triestë. Një kohë ishte drejtor i arkivave të Dubrovnikut dhe nga 1893 anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kroacisë. Gj. Gelciç është autor i përmbledhjes së inventarit të parë të arkivave të Dubrovnikut, të cilat janë ende në përdorim dhe të disa koleksioneve të burimeve arkivore. Botoi përmbledhjen e dokumenteve të Këshillit të Dubrovniku për vitet 1301-1379, “Monumenta Ragusina” dhe, së bashku me L. Thallóczin, botoi përmbledhjen me dokumente “Marrëdhëniet diplomatike në mes të Republikës së Dubrovnikut dhe mbretërisë së Hungarisë” për periudhën 1359-1526, në të cilën gjenden disa dokumente të rëndësishme mbi Skënderbeun dhe qytetet arbërore të Durrësit, Drishtit, Novobërdës, Prizrenit, Prishtinës, Trepçës etj. Në vitin 1880 botoi veprën “Memorie historike e Gjirit të Kotorrit” (më 2009 u botua shqip me titullin “Zeta dhe Dinastia e Balshajve”), e cila ofron sfondin e plotë të familjes arbërore të Balshajve, prejardhjen e familjes, shtrirjen e zotërimeve të tyre në Kosovë, për Betejën e Kosovës (1389), rrethanat politike e shoqërore të kohës etj. (Gjon Berisha)

GEORGIEV Vladimir (1908-1986). Gjuhëtar bullgar, albanolog, ballkanolog e indoeuropianist. Studioi në Universitetin e Sofjes për filologji klasike, ndërsa specializoi në Vjenë dhe më pas punoi në Universitetin e Sofjes, ku ishte edhe rektor. U mor me probleme të gjuhëve ballkanike dhe gjuhëve indoeuropiane. Në studimet ballkanologjike e trajtoi gjendjen gjuhësore të Ballkanit në lashtësi, probleme të etnogjenezës së popujve të Ballkanit, lidhjet ndërmjet popujve të lashtë të këtij gadishulli, ilirëve, trakasve dhe grekëve, probleme të substratit ballkanik dhe të lidhjes gjuhësore ballkanike. Mbrojti tezën se gjuha shqipe, burimisht, është më e afërt me dakomizishten. Botoi veprën “Hyrje në historinë e gjuhëve indo-europiane” (Introduction to the History of the Indo-European Languages). Interesim të veçantë tregoi për gjuhët e vdekura, si pellazgjishtja, hetitishtja, etruskishtja. U mor dhe me historinë e sllavishtes. Ishte presidenti i parë i Shoqatës së Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE). (Mensur Vokri)

GERAJ. Fshat në komunën e Preshevës, 8 km në lindje të qytetit. Shtrihet në shpatet perëndimore të Rujanit, përgjatë rrugës së vjetër Vranjë-Kumanovë, në lartësi mbidetare 480-520 m. Në popull njihet edhe si Talinoc. Dikur fshati ishte i ndarë në dy tërësi fizionomike. Me rritjen e numrit të banorëve dhe zgjerimin territorial këto tërësi janë bashkuar në një të vetme. Në vitin 2002 u regjistruan 1,388 banorë, kundrejt 539 banorëve që kishte në vitin 1961. Sipërfaqet e kullosave kanë orientuar popullsinë në zhvillimin e blegtorisë ekstensive, ndërsa banorët e fshatit njiheshin edhe si tregtarë të kafshëve në mbarë Luginën e Preshevës dhe më gjerë. Sot banorët merren me tregti, transport, blegtori, ndërsa një numër syresh gjendet me punë të përkohshme në botën e jashtme. (Arsim Ejupi)

GERGENTI. Ipeshkëv në Taphar (Tephra) i tokës së Homeriteve (Himjar) në Jemen (gjysma e parë e shek. VI). Shpeshherë referohet si Gregori i Tapharit dhe dita e Shën Gergentit festohet më 19 dhjetor. Nga të dhënat më të sigurta vendlindja duhet të jetë “në kufi me avarët” dhe identifikohet me Ulpianën antike në Dardani, ndonëse disa studiues mendojnë se lindi në Milano. Pas udhëtimit në Itali dhe

Sicili, shkoi në Egjipt për të jetuar i vetëm dhe, kur mbreti i Etiopisë, Elesbaas, pyeti Patriarkun e Aleksandrisë Proterios që të dërgojë një argjipeshkëv për ta pasuar atë që po vdiste, ky zgjodhi Gergentin. Kaloi në Felix Arabi, ku kryesoi zgjedhjen e mbretit Abramos në prani të Elesbaas, duke konvertuar shumë hebrej. Mbreti dhe ipeshkvi jetuan në harmoni për 30 vjet, madje Abramos nxori shumë ligje që dolën sipas sugjerimeve të Gergentit. Misioni i Gergentit në Arabi u zhvillua në kohën e Justinianit (518 ose 519) dhe ai pastaj duket se u dërgua në Etiopi. (Arben Arifi)

GEXHA Qamil (1934-2005). Historian, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, kurse studimet për histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit (1959). Studimet pasuniversitare dhe të doktoratës i kreu në Fakultetin Filozofik në Prishtinë (1982). Një kohë punoi si mësues në Rogovë të Hasit, më pas në Shkollën Ekonomike të Gjakovës, ndërsa më 1965 u zgjodh mësimdhënës i Shkollës së Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë. Deri në fund të jetës punoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Botoi studime dhe artikuj në disa revista shkencore dhe është autor i teksteve të historisë për nxënës të shkollave të mesme. Botoi veprat shkencore: “Shtypi i Malit të Zi për lëvizjen kombëtare shqiptare 1873-1912” dhe “Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze 1839-1912”. Dha kontribut për ngritjen e kuadrit shkencor në fushën e historisë. (Frashër Demaj)

GËRGURI Abdullah (1931-1994). Piktur konservator-restaurator. Lindi në Siboc të Podujevës. Kreu shkollimin fillor në Prishtinë, kurse në Pejë shkollën e mesme të artit. Pasi përfundoi Shkollën e Lartë Pedagogjike në Universitetin e Prishtinës, drejtimin e arteve figurative, u specializua në Beograd për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale (1971). Punoi për shumë vjet në Entin Krahinor për Mbrojtje e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë. Këtu i fitoi gradat dhe titujt profesionalë për konservim-restaurim të pikturës murale. Realizoi një numër projektesh për restaurimin e pikturave në monumente të karakterit fetar. Punoi në konservim-restaurimin e freskave në Manastirin e Graçanicës, në Patrikanën e Pejës, në kishat e Hoçës së Madhe

si dhe në pikturat dekorative në Xhaminë e Sinan Pashës në Prizren, në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë, në Xhaminë Fatih në Prishtinë, në Tyrbën e sulltan Muratit në Mazgit etj. Hapi disa ekspozita të pavarura dhe mori pjesë në ekspozita grupore në Kosovë dhe jashtë saj. (Fejaz Drançolli)

GËRGURI Ajet (1905-1947). Veprimtar dhe udhëheqës i shquar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në fshatin Duboc të Drenicës. Që në moshë të re



AJET GËRGURI

iu bashkua lëvizjes kaçke, çetës së Azem Galicës. Më 1922 në një luftim me xhandarmërinë serbe, u plagos. Pas vdekjes së Azem Bejtës (1924), bashkë me familjen e gjerë kaloi në Shqipëri, prej nga shpërngulet për në Turqi. Më pas kthehet në Shqipëri dhe vendoset në fshatin Dërmeneç të Fierit. Kreu Shkollën Bujqësore Amerikane të Kavajës. Si agronom punoi shumë vjet në Myzeqe, më pas në Tiranë. Më 1942 u kthye sërish në Kosovë dhe hapi një lokal hotelier në Lipjan, të cilën e mbajti deri më 1944. Gjatë Luftës së Dytë Botërore bashkëpunoi me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Në nëntor të vitit 1944 u punësua si agronom në Podujevë. Nuk u pajtua me ripushtimin e Kosovës nga serbia, as me sistemin komunist. Më 1945 iu bashkua LNDSH-së dhe në prill të vitit 1945 themeloi Organizatën nr. 2 të LNDSH-së, e cila vepronte kryesisht në Rrafshin e Kosovës. Organizata e tij bashkëpunoi ngushtë me Komitetin Qendror të organiztaës LNDSH-së të Shkupit, si dhe me organiztaën “Besa kombëtare”. Mbante lidhjet dhe ishte bashkërenditës i organizatave të LNDSH-së në Kosovë dhe në Maqedoni. Ishte njëri ndër organizatorët kryesorë të Kongresit të Lipovicës. Kur filloi ndjekja e pjesëtarëve të LNDSH-së nuk u largua nga Kosova dhe doli në mal, nga korriku i vitit 1945. U arrestua nga UDB-ja më 3 shkurt 1947 në fshatin Okrashticë të Drenicës. Gjykata e Prishtinës e dënoi me vdekje dhe u pushkatua më 31 gusht të vitit 1947. (Izber Hoti)

GËRGURI Salih (1938-). Gjyqtar ndërkom-bëtar i shahut. Lindi në Bardh të Madh, komuna e Obiliqit. Aktivitetin për organizimin

dhe zhvillimin e shahut në Kosovë e filloi në vitin 1967, kur u inkuadrua në udhëheqjen e Federatës së Shahut të Kosovës. Ndërkohë u bë gjyqtar i shahut dhe drejtoi shumë gara individuale dhe ekipore të Kosovës dhe ndërkombëtare. Ishte gjyqtar në dy olimpiada të shahut, atë të Shkupit në vitin 1972 dhe të Novi-Sadit në vitin 1990. Drejtoi takimet në 13 turne ndërkombëtare në Prishtinë. Në periudhën 1972-1989, drejtoi kampionatet individuale të Kosovës, një të Shqipërisë dhe një të ish-Jugosllavisë. Ishte gjyqtar në 20 festivale ndërkombëtare ekipore në 6 liga të dyta federative, në më shumë se 360 ndeshje të ligave e të kupës së Kosovës. S. Gërguri ishte kryetar i Federatës së Shahut të Kosovës (1983), kryetar i klubit të shahut “Prishtina”, anëtar i disa komisioneve profesionale në Federatën e Shahut të ish-Jugosllavisë etj. (Xhavit Kajtazi)

GËRMIA. Masivi malor i Gërmisë shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës, Prishtinës, në një sipërfaqe prej 62 km². Ky rajon malor i bashkëngjitet sistemit malor të



PARKU I GËRMISË

Rodopeve, që shtrihet nga mali i Karadakut të Shkupit në jug e deri te Kopaoniku në veri. Pika më e lartë e Gërmisë është maja e Butosit, me lartësi mbidetare 1,095 m, që paraqet nyjën hidrografike të lumit Vellushë dhe Badoc. Rajoni është i varfër me burime ujore. Masivi i Gërmisë përbëhet nga shkëmbinjtë gëlqerorë. Në disa hapësira janë të pranishëm dhe blloqet e mermerit. Në përbërjen pedologjike mbizotërojnë tokat e flishit dhe deluviumi deltinor. Temperatura mesatare vjetore sillet 9.8°C, me reshje vjetore 605 mm. Në Gërmi janë inventarizuar shumë lloje bimësh vaskulare (610 lloje), me disa lloje endemike të Ballkanit

(6 lloje). Nga veprimi i faktorit njeri viteve të fundit janë zhdukur disa lloje bimësh vaskulare. Në këtë lokalitet gjenden edhe lloje bimësh të ulëta: kërpudha (83 lloje), likene (51 lloje) dhe myshqe (14 lloje). Vegjetacioni përbëhet nga katër bashkësi: shpardi dhe qarri, bingu dhe shkoza, bingu dhe bashkësia e ahut, si dhe katër bashkësi barishtore. Janë konstatuar lloje të ndryshme të faunës: ujëtokësorë (5 lloje), zvarritës (7 lloje), shpendë (32 lloje), gjitarë (19 lloje) dhe insekte. Komuna e Prishtinës në vitin 1987 e shpalli Gërminë “Park regional” në shtrirje prej 1,060 ha. Me qëllim të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm, në vitin 2016 komuna e zgjeroi zonën e mbrojtur dhe e shpalli Gërminë “Peizazh të mbrojtur” në shtrirje prej 2,240 ha, që, sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), i takon kategorisë V të konservimit. (Behxhet Mustafa)

GËRMIZAJ Drita (1952-2001). Spikere, moderatore. Lindi në Kumanovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Shkup, ndërsa studimet për mjekësi dhe gjuhë angleze në Universitetin e Prishtinës. Ishte ndër të parat folëse (spikere) të lajmeve të TV Prishtinës që nga viti 1974, ku punoi deri më 1990. Një kohë punoi edhe në TV Era të Shkupit, duke ndihmuar në krijimin e gjeneratës së re të folësve televizivë në gjuhën shqipe në Maqedoni. Pos si folëse televizive, paraqitej edhe si gazetare televizive, kryesisht me kronika dhe reportazhe nga zhvillimet e ndryshme kulturore. Ishte laureate e katërfishtë e çmimit prestigjioz jugosllav për folësit televizivë “Gordana Boneti”, si dhe fituese e çmimit “Mikrofoni i artë” i Radio Prishtinës. Radio Televizioni i Kosovës (RTK) themeloi çmimin për folës televizivë me emrin e saj. (Shaqir Foniqi)

GËRMIZAJ Mahmut (1937-). Psikolog, mësimdhënës universitar. Lindi në Vlashnje të Prizrenit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa Shkollën Normale e kreu në Prizren. Studimet për psikologji të përgjithshme i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa studimet pasuniversitare i mbaroi në Beograd, në programin psikologji e punës. Pas diplomimit punoi si mësimdhënës i psikologjisë në Shkollën Normale të Prizrenit, në Entin Krahinor për Punësim të Kosovës. Kreu detyra të ndryshme në institucionet e vendit, si drejtor i Qendrës së Studentëve,

pastaj përgjegjës në shërbimin e riedukimit të Shtëpisë Korrektuese-Përmirësuese në Lipjan etj. Më 1972 u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, ndërsa më vonë, pas themelimit të Fakultetit të Kulturës Fizike, ligjëroi psikologjinë e përgjithshme dhe psikologjinë e sportit. Publikoi punime profesionale dhe shkencore, si dhe tekstin universitar “Psikologjia e sportit”. (Dashamir Bërxulli)

GËRMIZAJ Shykrane (1955-). Gjuhëtare, profesore. Lindi në Prizren, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesmen. Është diplomuar në Prishtinë për gjuhë angleze, ku më pas ka kryer



SHYKRANE
GËRMIZAJ

studimet pasuniversitare dhe ka mbrojtur tezën e disertacionit për kontributin e Stjuart Manit (Stuart Edward Mann) në albanistikë (2000). Në degën e anglishtes në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë punon që nga viti 1978 dhe mban titullin profesor i rregullt. Ishte kryeredaktore e revistës “Filologji”, pastaj drejtore e zyrës për barazi gjinore në Universitetin e Prishtinës (UP) dhe drejtore e qendrës së gjuhëve në UP. Botoi librat për studentë dhe monografitë “Anglishtja dhe shqipja - përjasje e kundërvënie” (2009) e “Stuart Manni - admirues i madh i shqipes dhe i shqiptarëve” (2004). Interes i saj kryesor në artikujt studimorë është rreth çështjeve të përkthimit, të metodologjisë së mësimdhënies, të leksikologjisë, të kontakteve të shqipes me anglishten etj. Ka realizuar disa projekte ndërkombëtare dhe ka përkthyer artikuj të ndryshëm nga shqipja në anglisht. (Lindita Rugova)

GËRVALLA Bardhosh (1951-1982). Veprimtar i lëvizjes ilegale, Hero i Kosovës. Lindi në Dubovik të Pejës. Bashkë me familje mërgoi në Slloveni dhe atje mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Gjuhën angleze e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Gjatë studimeve u mor edhe me muzikë dhe kompozoi këngë bashkë me të vëllanë, Jusufin. Më 1974 shkoi në Gjermani dhe u punësua në Ludwigsburg, në një zyrë për punë sociale. Aty u vu në kontakt me shumë mërgimtarë nga Kosova, të cilëve vazhdimisht u doli në ndihmë. Me arritjen e të vëllait, Ju-



BARDHOSH
GËRVALLA

sufit, në Gjermani, e intensifikoi veprimtarinë politike. Organizoi një mori manifestimesh të mërgimtarëve në qytete të ndryshme të Europës Perëndimore. Vuri kontakte me personalitete të ndryshme politike dhe kulturore të Gjermanisë dhe me gazetarë dhe përfaqësues të mjeteve të informimit. Duke qenë i shkathtë në organizim, shpesh u gjend në krye të demonstruesve në manifestime të ndryshme antijugosllave. Shtëpia e tij në Gjermani ishte e hapur për aktivistë të shumtë të lëvizjes dhe për njerëz të rëndomtë nga Kosova. U vra në një atentat afër Shtutgardit, bashkë me vëllanë Jusufin dhe Kadri Zekën, që e organizoi UDB-a jugosllave. (Daut Bislimi)

GËRVALLA Jusuf (1945-1982). Shkrimtar, veprimtar i çështjes kombëtare, Hero i Kosovës. Lindi në Dubovik të Deçanit. Kreu shkollimin në vendlindje, ndërsa studimet në Prishtinë dhe Lubjanë. Një kohë punoi si përkthyes në gazetën “Flaka e vëllazërimit” në Shkup, më pas gazetar në të përditshmen “Rilindja” në Prishtinë, ku ndoqi aktivitetet kulturore dhe veprimtaritë muzikore në Kosovë dhe më gjerë.



JUSUF GËRVALLA

Në fushën e letërsisë ka botuar veprat “Fluturojnë e bien” (1975), “Kanjushë e verdhë” (1978), “Shenjat e shenjta” (1980), “Rrotull” (1983). U bë i njohur edhe me veprat e tij dramatike dhe publicistike, si dhe në fushën e përkthimit. Gjithashtu dha kontribut edhe në fushën e muzikës. Për shkak të aktivitetit të tij atdhetar dhe politik, u detyrua të largohej nga Kosova dhe u vendos në Gjermani, ku mori statusin e të strehuarit politik. Në emigracion vazhdoi të merret me aktivitet politik, duke marrë pjesë në organizimet e mërgimtarëve nga Kosova. Fillimisht botoi gazetën “Lajmëtari i Lirisë” (1980), e më vonë “Zëri i Kosovës” (1981). J. Gërvalla përfaqëson intelektualin e përmasave të veçanta kombëtare, vepra e të cilit është projektuar përbrenda vizionit poetik dhe idealit kombëtar. Dimensionin krijues i veprës së tij i

shqipton temat letrare, të cilat ndërlidhen me fatin e njeriut dhe të popullit shqiptar. Konsiderohet njëri ndër veprimtarët më të rëndësishëm të çështjes kombëtare. U vra në Untergruppenbach, afër Shtutgartit në Gjermani, më 17 janar 1982. (Sali Bashota)

GËRVALLA Veli (1935-2014). Piktur, ilustrator. Lindi në Lupç të Poshtëm të Podujevës. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Podujevë dhe në Pejë, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup, kurse Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Disa vjet punoi si mësimdhënës i artit figurativ. Në vitin 1960 filloi punën ilustrator në gazetën “Rilindja”, ku punoi deri në pensionim. Ishte anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës që nga themelimi dhe mori pjesë në shumë aktivitete të saj, përfshirë disa ekspozita kolektive. V. Gërvalla me pasion punoi në teknikën e akuarelit, në të cilën me ndjesi të lartë e shpërfaqti kreativitetin e tij. Bëri shumë ilustrime për fëmijë në gazetën “Rilindja”, në revistën “Pionieri” dhe në botimet e Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore. Për punën e tij mori disa çmime dhe mirënjohje. (Bislim Aliu)

GËRVALLA Zeqir (1942 -). Shkrimtar. Lindi në fshatin Lupç i Poshtëm të Podujevës. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në Breznicë, Normalen në Prishtinë dhe Mitrovicë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë të gjatë punoi si referent i shitjes në redaksinë e gazetës së studentëve “Bota e re”, ndërsa nga viti 1991 drejtor i saj, deri në mbyllje. Më pas punoi në gazetën “Rilindja” dhe “Bujku”, deri në vitin 1999, kur emigroi në SHBA. Me krijimtari letrare merret që në moshë të re. Shkruan poezi për fëmijë dhe të rritur. Për shkak të angazhimit politik, u burgos në vitin 1964 dhe u dënua me 12 vjet burg, si bashkorganizator i organizatës ilegale LRBSH. Pas daljes nga burgu vazhdon të shkruajë poezi, por për shkak të ndalesave, ato i botoi me pseudonimet si Zeqir Gurraj, Jusuf Berati, Hanëmshahe Bajrami, Flakron Gurari, Sokol Llapi, Hana Malësori etj. Që nga viti 1990 filloi t'i botojë veprat letrare. Botoi këto vëllime poetike: “Prania e sfinksit” (1990), “Det e moçal ballë për ballë” (1993), “Daullet e pranverimit” (1994), “Në rrugët e dritës” (1998), “Ekspozita e mëmëdheut” (1998), “Lulëzimi i rrënjës” (2000), “Me o(r)ë Kosovë”

(2009), “Poema e ribashkimit” (2012). Jeton në SHBA. (Munish Hyseni)

GËSHTENJA. (*Castanea sativa* Mill.) Dru i lartë 20-35 m, gjetherënës, me lëvore të murrme e të çarë për së gjati. Gjethet i ka të thjeshta, të gjata 12-20 cm, në formë heshte, të zgjatur dhe me maje, buzë të dhëmbëzuara si sharrë. Lulet i ka njëseksore ose poligame. Lulëzon në qershor, para gjethimit. Lulet mashkullore i ka të vendosura në levarë cilindrikë e të drejtuar përpjetë, me periant



gjashtanëtarësh e me shumë thekë (10-20) me fille të gjata. Lulet femërore janë të vendosura në fund të levarëve mashkullore, shpesh 1-3 (4-7) së bashku, të vendosura në një gishtje (kupullë), e cila gjatë pjekjes së frytit bëhet gjembore (zhguall me gjemba), që më vonë pëlçet në katër flegra, me ç'rast lirohen tre fruta arrëza (akene). Gështenja është mjaft e rëndësishme, veçanërisht fryti i saj i pasur me amidon, proteinë, yndyrë, me vlerë të lartë ushqimore, me përdorim në mënyra të ndryshme. Druri i gështenjës është i cilësisë së mirë, punohet lehtë, është i qëndrueshëm dhe përdoret për prodhimin e orendive të ndryshme. Lëvorja dhe gjethet përmbajnë përqindje të lartë të tanineve, që përdoren për regjie lëkurash e ngjyrosje të ndryshme. Gështenja është bimë entomofile, shumë e rëndësishme për bletari. Lulëzon vonë qershor-korrik, koha kur bletët gjejnë kullosë të mjaftueshme për grumbullimin e mjaltit. Në Kosovë gështenja është e përhapur në relacionin ndërmjet Pejës e Gjakovës, në rrënjëzat e Alpeve Shqiptare dhe në rrethinën e Prizrenit, ku krijon pyjet e saj me tiparet e vegjetacionit submesdhetar. Pyjet e gështenjës shtrihen në lartësinë mbidetare 500-900 m dhe janë të thjeshta, ose të përziera me esenca të tjera drunore gjethegjera. (Feriz Krasniqi)

GLENI Misha (Glenny) (1958). Gazetar britanik, i specializuar për Europën Juglindore. Është i biri i studiuesit rus, akademikut Mihail Gleni (Michail Glenny). U edukua në kolegjin Magdalen në Oksford dhe vijoi studimet e larta në Universitetin e Bristolit (Britani e Madhe) dhe Universitetin “Chales” të Pragës. U



MISHA GLENI

aktivizua si korrespondent i gazetës “The Guardian” e më vonë i BBC për Europën Qendrore e Juglindore. U bë i njohur për raportet, informacionet dhe analizat mbi rënien e komunizmit në Europën Lindore, në veçanti mbi luftërat në ish-Jugosllavi, në fillim të viteve '90. Gjatë tre vjetëve u aktivizua me organizatat joqeveritare për rindërtimin e Serbisë, të Maqedonisë dhe të Kosovës. Është autor i disa librave mbi zhvillimet në Ballkan: “Rilindja e Historisë: Europa Lindore në vitet e demokracisë” (1990), “Shpërbërja e Jugosllavisë” (1992) dhe “Ballkani: Nacionalizmi, lufta dhe Fuqitë e Mëdha 1804-1999” (1999). U shqua si njohës dhe vëzhgues i krimit të organizuar në Ballkan, në Europë dhe më gjerë dhe i krimit kibernetik, që i pasqyroi në librat “McMafia” (2009) dhe “Tregu i zi” (2011). Është laureat i disa çmimeve ndërkombëtare. (Endrit Musaj)

GLISHIQ (Glišić) Jovan (?-). Arkeolog serb. Studimet për arkeologji i kreu në Universitetin e Beogradit, ku edhe doktoroi. Punoi si kustosi i Muzeut të Kosovës deri në vitin 1999 dhe ishte njohës i mirë i kulturave dhe i proceseve neolitike në Kosovë dhe më gjerë. Pos tjerash, gërmoi lokalitetin e Glladnicës te Graçanica, ku u konstatuan shtresat e neolitit të hershëm (kultura e Starçevës), si dhe të bronzit të vonë. Në lokalitet u zbulua dhe figurina më e hershme cilindrike më masive prej argjile të pjekur e Kosovës. Bëri dhe gërmime sistematike në Reshtan të Suharekës (1966-1967), pas atyre të J. Todoroviçit (1963), pastaj në Runik të Skënderajt (1966-1968, 1983-1984), gërmime shtesë në Hisar të Suharekës (1978), në Gradinën e Gadimes së Epërme etj. Bashkëgërmoi në nekropolin tumar të Romajës (që rezultoi me botimin e librit “Romaja parahistorike”) dhe ishte këshilltar shkencor i gërmimeve arkeologjike në lokalitetin e Vërmicës te Prizreni. Kontribuoi mjaft për zhvillimin e arkeologjisë së Kosovës, si dhe për themelimin e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. Në vitin 1981 iu nënshtrua plotësisht politikës antishqiptare të Beogradit, madje edhe duke akuzuar publikisht për shkatërrimin e varrezave “sllave” të Vërmicës, ku gërmoi

edhe vetë dhe materiali i të cilit u ekspozua në Muzeun Arkeologjik të Prizrenit. (Edi Shukriu)

GLLAVICA Adem (1916-2001). Veprimtar antikomunist gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në fshatin Gllavicë të Lipjanit. Kreu Medresenë e Madhe në Shkup, ndërsa studimet për agronomi i mbaroi në Zagreb. Në atë kohë u bë anëtar i organizatës “Besa”, e cila tubonte studentët shqiptarë që studionin në Beograd dhe Zagreb. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte nënprefekt i Ferizajt, drejtor i kompleksit bujqësor shtetëror në Fushë-Kosovë, mësimdhënës në normalen-gjimmnazin “Sami Frashri” në Prishtinë, ndërsa në vitin 1944 u zgjodh kryetar i Komitetit të Rinisë Nacionaliste për Mbrojtjen e Atdheut. Mori pjesë në shumë beteja kundër depërtimit të njësiteve partizane në Kosovë. Më 1945 iku në Greqi, ku qëndroi deri në vitin 1949, pastaj emigroi në Gjermani dhe së fundi në Australi. Atje punoi në Institutin e Hortikulturës (1952-1972), në Tatura të shtetit Viktoria, ku drejtoi eksperimente shkencore në fushën e pomologjisë dhe të fiziologjisë së bimëve në Luginën e Gulburnit, e ngjashme me fushën e Kosovës. Publikoi shumë punime në revista të njohura shkencore. Përfaqësoi Australinë në konferenca shkencore në vende të ndryshme të botës. Vdiq në qytetin Perth të Australisë. (Muhamet Shatri)

GLOBOÇICA. Fshat në jugperëndim të Kaçanikut, shtrihet rrëzë maleve të Sharrit, në brezin kufitar me Maqedoninë. Është vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë. Sipërfaqja është 14.1 km², numri i banorëve 1,287 dhe dendësia 91 b/km². Nëpër territorin e fshatit kalon rruga magjistrale që lidh Kosovën me Maqedoninë. Në të ndodhet pika kufitare e Jazhincës. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të hershme. Në vitin 1389 përmendet me emrin Dëllboqica, ndërsa në defterin osman (1452) është regjistruar me emrin Dlaboqica. Në vitin 2011 fshati kishte 1,287 banorë, ndaj 689 banorë në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me blegtori dhe bletari. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore, stacionin shëndetësor, shtëpinë e kulturës, disa biznese të vogla etj. (Shpend Agaj)

GLOGOCI. Shih: DRENASI.

GLLOGJANI. Fshat në komunën e Deçanit. Është vendbanim fushor i tipit të dendur. Shtrihet në lartësi mbidetare 505 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 6.4 km², nga e cila 74.6% janë sipërfaqe bujqësore, 20% pyje dhe 5.4% zonë e ndërtuar. Sipas regjistrimit të fundit (2011) numri i popullsisë është 984 banorë. Popullsia merret me bujqësi dhe blegtori. Gllogjani gjatë luftës së fundit të vitit 1998/1999 ishte vatër e UÇK-së dhe e rezistencës kundër pushtuesit serb. Elementet identifikuese të fshatit janë kullat e vjetra, të cila paraqesin objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën fillore dhe disa objektet të tjera shërbyese. (Idriz Shala)

GNIDOVEC Ipeshkëv Janez (1873-1939). Prift katolik slloven, anëtar i Kongregatës Misionare të Lazaristëve, ipeshkëv i Ipeshkvisë Shkup-Prizren. Lindi në fshatin Veliki Lipovec,



IPESHKËV JANEZ
GNIDOVEC

në Dioqezën e Lubjanës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Novo Mesto. Në Universitetin e Vjenës studioi për filologji klasike, gjuhë sllovene dhe gjermane, më pas, më 1905, u emërua profesor dhe drejtor i parë i gjimnazit ipshkvnor të Kolegjit të Shën Stanisllavit në Shentvid afër Lubjanës. Në vitin 1896 u shugurua meshtar me detyrën e kapelanit në Famullinë Idrija (Slloveni). Papa Piu XI, më 1924 e emëroi ipeshkëv të Ipeshkvisë Shkup-Prizren, duke e trashëguar në këtë detyrë Lazër Mjedën. Shugurimin ipeshkvnor e mori në Kishën e Zembrës së Krishtit në Tabor, në Lubjanë dhe më 1924 u vendos në Prizren. Ishte mësues i Agnesë Gonxhe Bojaxhiut - Nënë Terezës. E mësoi shumë shpejt gjuhën shqipe dhe u dallua me punën e tij në ndërtimin e shumë kishave nëpër qytete e fshatra të Kosovës, si në Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Smaq, Ferizaj, Letnicë, Kravasari, Zllakuçan, Dushanovë, Peshter, Dunavë etj. Në vitin 1934 selinë ipeshkvnore e shpërnguli në Shkup. (Gjon Berisha)

GOCA Kemajl (1976-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Zaskok, ndërkaq të mesmen në Ferizaj. Hapat e parë në gazetarinë sportive i filloi në vitin

1997, duke bashkëpunuar me gazetën javore "Sport plus". Pas luftës, në vitin 1999, punoi si korrespondent në gazetën ditore "Dardania press"; pastaj korrespondent i sportit në gazetën ditore "Kosova sot". Në vitin 2000 filloi punë në gazetën "Bota sot". (Florim Maliqaj)

GOÇI Rexhep (1947-). Piktur, kritik arti. Lindi në Molliq të Gjakovës. Kreu shkollën fillore në Junik, Normalen në Prizren, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike (degën e artit figurativ) në Prishtinë. U diplomua në Akademinë Mbretërore të Arteve në Bruksel më 1972. Punoi si mësimdhënës në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë dhe bashkëpunëtor profesional në Galerinë e Arteve të Kosovës (1987-2002). Ishte kryetar i Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës në periudhën 1987-2002. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive dhe realizoi disa ekspozita personale: në Ann Arbor, Miçigan (2000) dhe Roçester Hills (2003) në SHBA, pastaj në Couvet (Zvicër, 2005) dhe në Prishtinë (2002 dhe 2006). Është autor i tekstit shkollor "Edukata estetike" (1979) për shkolla të mesme, "Arti figurativ" (1983) dhe "Kultura figurative" (1988) për shkolla fillore. Është bashkautor i monografive "Arti bashkëkohor i Kosovës" (1988) dhe "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në artet figurative" (1998), pastaj i librit me ese "Formësime artistike" (2013), i vëllimit me poezi "Vallet mitike" (2013) etj. Harmonia e ngjyrave, drejtpeshimi i formave dhe kompozicioni origjinal janë veçoritë e pikturës së tij. (Blerim Luzha)

GODANCI Xhejlane (1967-). Aktore. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Përfundoi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet: "Ventrusët" (1987), "Vdekja me vjen prej syve të tillë" (1987), "Doktor Fausti" (1988), "Servisi i shpirtit" (1995), "Koprraci" (1997), "Babai" (1997), "Fluturimi mbi folenë e qyqes" (2000), "Trëndafili tatuazh" (2002), "Aromë portokalli" (2003), "Mbas zonjushës Xhuli" (2013) etj. Në Teatrin "Dodona" luajti në shfaqjet: "Dëshmitari kryesor" (1994), "Rikardi III" (1996), "Karrigat" (1997), "Stjuardesat" (1997) etj., si dhe në disa shfaqje me kukulla. Luajti gjithashtu në filmin "Rojet e mjegullës" (1987). Me rolet e saj njihet edhe si aktore e serialeve televizive vendore, si: "Familja moderne", "Jeta e një toke" (2005) dhe "Brenda drejtësisë" (2005-2006). (Doruntina Basha)

GOGA Rudi (1948-). Piktor. Lindi në Ulqin. Kreu Akademinë e Arteve në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare në Dyseldorf të Gjermanisë. Është anëtar i Shoqatës së



RUDI GOGA

Artistëve Figurativë të Ulqinit dhe të Malit të Zi, në kuadër të së cilave ekspozoi brenda dhe jashtë vendit. Në vitet 1985-1988 ishte kustos arti në Kullën e Balshajve në Ulqin. Opusi i tij krijues shquhet për trajtimin e figuracionit, në të shumtën e rasteve të nudos, që është pjesë përbërëse e krijimtarisë së tij. Është piktor ekspresiv me elemente moderniste. Në indeksin e prezantimeve të tij janë mbi 60 ekspozita kolektive dhe mbi 40 personale, nga të cilat disa syresh në Ulqin, pastaj në Tivar, në Podgoricë, në Kotorr, Herceg-Novi, në Prishtinë (Galeria e Arteve e Kosovës), në Dyseldorf, Këln dhe Mynster (Gjermani), si dhe në Tiranë, Paris, Nju-Jork etj. Është fitues i disa çmimeve prestigjioze për arte figurative dhe pikturë në Prishtinë, Ulqin dhe Tiranë. (Rexhev Ferri)

GOJANI Ismajl (1943-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit



ISMAJL GOJANI

të Beogradit (1970), ato pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa studimet e doktoratës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës (UP) (1986). Pas diplomimit punoi në fabrikën "Metaliku" në Gjakovë, kurse nga viti 1973 deri në pensionim punoi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të UP-së. Për një kohë të gjatë ushtroi funksione në fakultet dhe në organet drejtuese të UP-së. Ka botuar një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe ka bërë vizita studimore në Suedi, Bullgari dhe Austri. (Xhevat Perjuci)

GOJANI Mikel (1956-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Dugajevë të komunës së Klinës. Mbaroi shkollimin fillor në Drenoc, të mesmin në Klinë. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike

në Gjakovë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës dhe bibliotekar në shkollën fillore "Atë Shtjefën Gjeçovi" në Zllakuqan. Një kohë ka punuar edhe koordinator në bibliotekën e qytetit "Kongresi i Manastirit" në Klinë, pastaj zyrtar komunal për informim publik dhe gazetar në gazetën "Bota sot" në Prishtinë. Me krijimtari letrare është marrë që nga vitet '70 të shekullit të kaluar. Shkruan prozë e poezi për fëmijë dhe të rritur, kritikë letrare, udhëpërshkrime dhe publicistikë. Botoi këto vepra: "Zëri i largët" (1990), "Udhëtimi pas të kaluarit të vdekjes" (1994), "Shëti nëpër atdhe" (1995), "Kroi që rrjedh rrëzë bjeshkës" (1996), "Në profil kah Jugu" (1996), "Ai vjen me shirat e pranverës" (1996), "Udhë e shkronjave" (1997), "Diell dhe reshje mbi Morenë" (2005), "Tradita dhe bashkëkohësia" (2007), "Mendësi krijuese" (2008), "Fund i prituri" (2010), "Bota e mendimit" (2012). Është autor dhe bashkautor i disa monografive. (Munish Hyseni)

GOJÇAJ Anton (1966-). Shkrimtar. Lindi në Podgoricë. Ndoqi studimet për letërsi e gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Për disa vjet jetoi në Gjermani. Me rikthimin në vendlindje, fillimisht punoi si lektor në gazetën "Koha javore" (2002-2008), kurse aktualisht punon në Entin e Shkollimit, këshilltar për lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Shkruan prozë e poezi, recensione e kritikë letrare dhe merret me studime letrare. Botoi këto vepra: "Poezi" (2001), përmbledhjen me tregime "Qengj i harruar natën në mal" (2003), librat me studime dhe ese letrare "Tema e heroit nacional në letërsi" (2004), "Fakticiteti në letërsi, proza letrare e Anton Harapit", (2007), "Shija e librit" (2009), "Biblioteka e Hirushës" (2011) dhe romanin "Passio" (2004). Disa tregime të tij dhe romani "Passio" janë përkthyer dhe botuar në gjuhën malazeze. Në Universitetin e Malit të Zi, në degën e mësuesisë në gjuhën shqipe, mban lëndën e letërsisë për fëmijë. (Haxhi Shabani)

GOJËDHËNAT. Krijime të shkurtra folklorike, që e marrin subjektin e tyre nga besimet dhe besëtytnitë popullore. Gojëdhënat ofrojnë të dhëna për ngjarje, figura, vende dhe dukuri të ndryshme dhe shpjegojnë, sipas besimeve popullore, origjinën e toponimeve, të frymorëve,

të bëmave të personaliteteve historike dhe johistorike dhe të ndonjë dukurie apo fenomeni natyror. Disa studiues i quajnë legjenda, derisa të tjerët bëjnë dallimin e qartë ndërmjet gojëdhënës dhe legjendës. Gojëdhëna kërkon t'i besohet si nga rrëfimtari, ashtu edhe nga dëgjuesit; synon t'i rrëfejë gjërat sikur kanë ndodhur me të vërtetë, prandaj është rrëfim i lokalizuar, që i përket qytetit të caktuar, lumit, shkëmbit apo personit. Ajo përfundon me "dëshmi" materiale lidhur me ndodhinë e rrëfyer, si përjetim apo si përvojë personale. Sipas objektit të trajtimit, dallohen gojëdhënat e toponimeve, gojëdhëna frymorësh, gojëdhëna figurash johistorike, gojëdhëna mitologjike etj. Në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare janë të njohura gojëdhënat për fuqinë mbinatyrore të Skënderbeut, për luftërat e tij me turqit, pastaj gojëdhënat për Kalanë e Shkodrës, për Urën e Shenjtë, gojëdhënat për qyqen etj. (Myzafere Mustafa)

GOLEMI Bardhyl (1932-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor, akademik. Lindi në Dhrovjan të Sarandës, Shqipëri. Kreu gjimnazin në Vlorë, u diplomua në Institutin e Lartë Politeknik në Tiranë (1955)



BARDHYL GOLEMI

dhe më pas ndoqi një specializim në "Grand Ecol d'Electricite" në Paris (1972). Arriti gradën kandidatit në shkencave më 1979 dhe merr titujt e docentit dhe profesorit universitar (1981). Më 1999 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ishte themelues dhe drejtues shumëvjeçar i katedrës së elektroteknikës në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT). Është autor i shumë kurrikulave universitare dhe pasuniversitare dhe ka kontribuar në shkollën doktorale të inxhinierisë elektrike. Për 10 vjet ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Prishtinës. Ka botuar me bashkautorë librat: "Zhvillimi i arsimit të lartë në Shqipëri" (1986), "Shkolla shqiptare e elektroteknikës" (2004), "Universiteti i Tiranës" (1957-2007). Ka kryer studime dhe referime në fushën e lëkundjeve elektrike, të teorisë së qarqeve elektrike dhe ka botuar artikuj shkencorë në buletinet shkencore të UPT-së. B. Golemi ka dhënë kontribut në trajtimin e problemeve të bioelektromagnetizmit dhe të studimeve për korridoret elektromagnetike të linjave të

telefonisë në Shqipëri etj. Është vlerësuar me çmime, mirënjohje dhe dekorata. (Isuf Krasniqi).

GOLESHI. Mal në zonën qendrore të Kosovës, me lartësi 1,019 m. Në anën veriore ndahet prej Çiçavicës nga lugina e lumit Drenica, në lindje është i përkufizuar nga fushëgropa e Kosovës,



MAJA E GOLESHIT


ndërsa në perëndim kufizohet me fushëgropën e Drenicës. Ka formën e një trekëndëshi të zgjatur, me gjatësi prej 13 km, gjerësi 2.5-3 km, me shtrirje veriperëndim-verilindje. Ndërtohet nga shkëmbinj të magmatikë të mesozoikut të përfaqësuar nga serpentinitet dhe peridotitet, të cilët i janë nënshtruar shkatërrimit dhe denudacionit. Relievi është kodrinor-malor, i copëtuar dhe përfaqësohet me qafa malore të ulëta, shpate dhe kurrizore të sheshta malore, me hidrografi sipërfaqësore të varfër. Në pjesën më të madhe është i zhveshur, pa bimësi. Disa pjesë nga ana veriore dhe perëndimore janë të mbuluara me shkurre të dushkut, ndërsa në anët e tjera haset rrallë vegjetacion barishtor. Në rrëzën lindore të Goleshit buron gurra e fuqishme e Vrellës. Në Golesh (Magurë), ndodhet miniera nëntokësore e magnezitit dhe miniera sipërfaqësore e nikelit silikat (Gllavicë). (Shpejtim Bulliqi)

GOLLAKU. Tërësi malore dhe trevë etno-geografike, e cila shtrihet në pjesën lindore të Kosovës. Ndodhet në mes të luginës së Llapit në veri, Moravës së Binçës në jug, Malësisë së Bujanocit në lindje dhe Fushës së Kosovës në perëndim. Karakterizohet nga një reliev kodrinor-malor me lartësi 700-1,200 m, dendësisht i copëtuar nga rrjeti i degëve të majta të Moravës së Binçës në juglindje dhe degëve të djathta të Sitnicës nga jugperëndimi.

Lartësitë më të mëdha janë Mali i Madh (1,260 m), Gërbeshi (1,221 m) Zllashi (1,210 m) etj., ndërsa në skajin lindor të Gollakut shtrihet Guri Zi (1,228 m), Kitka (1,154 m) etj. Gollaku ndërtohet nga rreshtet me granite të paleozoikut, ultrabazikët, flishi etj. të mesozoikut. Në përgjithësi relievi i Gollakut karakterizohet nga një trajtë e valëzuar me kurrize të buta dhe lugje, me ndryshime morfologjike të vogla deri mesatare. Dominon klima e mesme kontinentale me temperaturë mesatare vjetore mes 8-9°C dhe me reshjet vjetore deri 800 mm. Kryesisht mbulohet nga pyjet e dushkut, relativisht të degraduara. Popullsia e kësaj ane këtë trevë e quan “Malësia e Gollakut”. Një pjesë e kësaj zone graviton drejt Prishtinës dhe Podujevës, ndërsa pjesa tjetër drejt Kamenicës (Dardanës). Përfshin disa vendbanime, të cilat administrativisht u takojnë disa komunave, prej tyre disa edhe në pjesën e Kosovës Lindore (Serbi). Nga pikëpamja etnografike nuk dallon shumë nga ajo e Rrafshit të Kosovës. (Shpejtim Bulliqi)

GOLLOPENI Refki (1965-). Dizajner. Lindi në Dobërdelan të Suharekës. Kreu shkollimin fillor në Suharekë, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për dizajn grafik i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1989). Bëri disa udhëtime studimore jashtë vendit. Punoi si mësimdhënës i artit, këshilltar pedagogjik për lëndën e artit (1993-1998). Punoi menaxher i kulturës në komunën e Suharekës, ku themeloi Koloninë artistike “Festari” dhe u zgjodh drejtor artistik i Festivalit të filmit të animuar “Taffest”. Krijimtaria e tij artistike kohët e fundit, përveç dizajnit, përfshin dhe pikturën abstrakte. Hapi një numër ekspozitash personale dhe mori pjesë në ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë. U shpërblye me disa çmime: posteri promovues i 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, disa projekte ideore, logo, emblema etj. (Zeni Balazhi)

GORA Afrim (1948-). Skenograf, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor. Në Pejë kreu edhe Shkollën e Mesme të Arteve, kurse në Beograd Akademikën e Arteve të Aplikuara (1974). Nga viti 1975 deri në vitin 1991 punoi në Radio Televizionin e Prishtinës, si skenograf dhe kostumograf. Aktivitetin e tij si skenograf i teatrit e filloi



AFRIM GORA

në vitet '70, kur punoi skenograf në Teatrin Krahinor të Kosovës për shfaqjet “Beselam pse më flijojnë” dhe “Pylli”. Bashkëpunoi edhe me qendra të tjera teatrore brenda dhe jashtë Kosovës, ku shquhen skenografite për shfaqjen “Vetëvrasje në ditëlindje”, “Zhorzh Dandeni”, “Unë burri i vjehrrës”, “Nëna udhëton në parajsë” në Teatrin e Pejës etj. Pas luftës (1999) duhen veçuar skenografite për shfaqjet “Korridorët e tmerrit”, “Im atë e donte Adolfin” etj. Punoi një numër të skenografive edhe për filma, si: “Gjurmë të bardha”, “Kukumi”, “Gomarët e kufirit”. Nga viti 2000 e deri në vitin 2010 ishte skenograf dhe drejtor artistik në Teatrin “Istref Begolli” të Pejës, ndërsa nga viti 2002 e deri në pensionim (2013) punoi edhe në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku ligjëroi lëndën e skenografisë. (Besim Rexhaj)

GORA. Trevë etnogeografike malore në skajin jugor të Kosovës, në rrëzat e Malit të Sharrit, kufizohet në lindje me Maqedoninë, në perëndim me Shqipërinë, kurse në pjesën veriore me trevën e Opojës. Ka sipërfaqe 300 km². Gora ndërtohet kryesisht me formacione të vjetra gjeologjike (paleozoik), të cilat përfaqësohen me filite, rreshpe sericitike, metaranorë, mermerë, gëlqerorë të rikristalizuar, metaporfire, meta-granodiorite, metasienite, si dhe depozitime të periudhave të reja gjeologjike që përfaqësohen me morena të formuara nga akullnajat. Relievi është modeluar nga veprimtaria fluvio-glaciale. Ka lartësi mesatare mbidetare 1,700 m dhe shtrihet ndërmjet 738-2,644 m. Karakterizohet me dimra të ftohtë dhe të gjatë dhe vera të shkurtra e të freskëta. Temperatura mesatare vjetore lëkundet ndërmjet 4-8°C, kurse reshjet mesatare vjetore janë rreth 1,200 mm. Ka burime të shumta ujore dhe rrjet të dendur lumor. Lumenjtë janë të shkurtër dhe rrjedhin në drejtim të lumit të Plavës dhe vendeve fqinje. Ka edhe disa liqene akullnajore (rreth 10, më i madhi i Shutmanit). Në lumin Brod është ndërtuar edhe hidrocentrali i Dikancës. Dominojnë tokat rankeri dhe të murrme në shkëmbinj kompaktë. Dallohet për sipërfaqet e shumta me kullosa alpine, të cilat shfrytëzohen për blegtori.

Gora ka gjithsej 17 vendbanime, kryesisht të tipit të grumbulluar. Me regjistrimin e vitit 1948, në Gorë jetonin 11,166 banorë, kurse në vitin 1991 u vlerësua se jetojnë 17,574 banorë. Me regjistrimin e vitit 2011, të pranishëm nëpër vendbanime ishin 14,275 banorë. Një pjesë e madhe e popullsisë jeton në migrim. Struktura etnike përfaqësohet nga goranët (61%), boshnjakët (28%), shqiptarët (7%) dhe të tjerët (4%). Popullsia merret me blegtori dhe pylltari. Vendbanimet më të mëdha janë: Dragashi (1,098 banorë), si qendër komunale dhe Restelica (4,698 banorë), që është vendbanimi më jugor i Kosovës. (Valbon Bytyçi)

GORANCI Flaka (1985-). Mezosoprano. Lindi në Gjakovë, ku mori mësimet e para për piano. Më 2004 i filloi studimet për solokëndim në Akademinë e Muzikës në Tiranë. Më 2006 u



FLAKA GORANCI

zgjodh nga regjisorja E. Stewart nga La MaMa Theatre etc. i Nju-Jorkut dhe realizoi rolin e Armillas në veprën operistike-teatrale “Il Corvo” që hapi Bienalen e Venecias. Më 2008 realizoi rolin e Rozinës te “Berberi i Seviljes” në Teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë dhe rolin e Kerubinos nga “Martesa e Figaros”. Më 2008 fitoi bursë për master nga “Buchmann-Mehta” për Shkollën e Muzikës në Tel Aviv. Për dy vjet studimi realizoi rolin e Dorabeles nga opera “Cosi fan tutte”, Dido nga “Dido dhe Enea” dhe “Die Mutter Der Jasager” (hebraisht). Është pjesëmarrëse në koncerte në Kosovë, Angli, Itali, Amerikë, Izrael, Gjermani, Zvicër, Austri, Shqipëri etj. Performoi me: Concentus Musicus, Orkestra e Operës dhe e Radio-Tiranës, Das Salonorchester Bad Schallerbach (Austri), Orkestra e Ramat Hasharon e Buchmann-Mehta School Orchestra of Tau (Izrael), Orkestrën Filarmonike të Maqedonisë, të Kosovës dhe Shqipërisë. E vendosur në Vjenë, vitin 2015 e përmbylli me promovimin e pestë në Cyrih të CD-së “Albanian flowers” pas atyre në Vjenë, Tiranë, Prishtinë dhe Gjakovë. (Sami Piraj)

GORANCI Ilhami (1941-). Mjek, oftalmolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e përfundoi në vendlindje,



ILHAMI GORANCI

ndërsa të mesmen në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1969), ndërsa specializimin për oftalmologji e përfundoi në Zagreb. Vazhdoi ngjritjen profesionale në Beograd dhe gjatë vitit 1982 në Upsalla të Suedisë, ku pas kthimit themeloi kabinetin e glaukomës në Prishtinë. Temën e magistraturës e mbrojti në Zagreb, kurse temën e doktoratës e mbrojti në vitin 1985 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ndërkohë, më 1977 u zgjodh asistent në lëndën e oftalmologjisë, ndërsa më pas mori titujt përkatës, përfshirë edhe titullin profesor ordinar i lëndës së oftalmologjisë. Ka marrë pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe ka publikuar një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. Ishte drejtor i klinikës gjatë viteve 1999-2002 dhe 2003-2006. Në vitin 2003, si bashkautor, botoi tekstin “Okulistika” (2013) për studentë dhe mjekë, ndërsa në vitin 2015 tekstin universitar “Oftalmologjia” për mjekë, mjekë specialistë dhe studentë. (Isuf Dedushaj)

GORANCI Mjellma (1977-). Dizajnere grafike, piktore. Lindi në Prishtinë. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, drejtimi i dizajnit grafik (2002). Nga viti 1998 mbajti ekspozita personale dhe u përfshi në ekspozita të përbashkëta me punime nga piktura, dizajni dhe qeramika. Mori pjesë në ekspozita brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2006 hapi ekspozitën e parë personale “Femra, lule dhe molla” te “Hani i 2 Robertëve” në Prishtinë. Në piktura përdor ngjyra të ndezura dhe përmes kolazhit e paralelizmit që reflekton ndërmjet gruas dhe luleve shpreh perceptimet e saj të jashtme dhe botën e saj të brendshme. (Ilir Muharremi)

GORANÇJA. Gjuhë e komunitetit goran në Gorë të Dragashit në Kosovë, në Shqipëri përgjatë kufirit me Kosovën në territorin e Maleve të Sharrit dhe të Koritnikut dhe në disa fshatra në Tetovë të Maqedonisë. Në këtë territor kjo gjuhë flitet nga rreth 15,000 folës. Është e afërt me maqedonishten dhe me torlakishten e dialektin sllav të Prizrenit

dhe të Moravës së Poshtme, me një ndikim të dukshëm edhe të turqishtes. Studiuesit bullgarë e konsiderojnë popullatën e Gorës popullatë bullgare. Folësit e quajnë edhe “nashinski”, “goranski” ose “torbeshki”. Kjo gjuhë nuk është e njëjtë me gjuhën boshnjake si emërtim i dekadës së fundit në Kosovë, gjë që përkon edhe me ndarjen e etnitetit goran e boshnjak. Më 2007 në Bullgari u botua edhe fjalori goran (nashinski)-shqip me mbi 40,000 fjalë, hartuar nga Nazif Dokle. (Senad Neziri)

GORANËT. Popullatë sllavishtfolëse, e cila banon në krahinën etnografike të Gorës që ndahet gjeografikisht midis Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Dokumenti më i vjetër që përmend këtë krahinë mbetet krisobula për Manastirin në ngritje të Shenjtorëve Mëhill e Gabriel të Prizrenit (1348?). Nga emrat e katundeve, të shumë mikrotoponimeve dhe emra e vëllazërive që janë ruajtur deri në ditë tonat, rezultojnë se popullata gorane ishte këtu para viti 1348. Çështja e prejardhjes së goranëve shpesh është mjegulluar, si rezultat i tendencave për zgjerime territoriale të Bullgarisë, të Serbisë dhe së fundi edhe të Maqedonisë.

Studiuesi çek Leopold Geitler (1847-1885), mbi bazën e traditës poetike të pomakëve të Bullgarisë, në librin e tij “Tradita poetike e trakasve dhe e bullgarëve” (Vjenë, 1878), pomakët (d.m.th. edhe torbeshët, përkatësisht goranët) e Bullgarisë i mbante për pasardhës të trakasve, ashtu si edhe dijetari frëng Dozon, i cili i mbante me prejardhje trakase edhe pomakët e Maqedonisë. Pararendësit e goranëve të Kosovës, si pjesë e një etnie numerikisht më të madhe të njohur në Bullgari, Greqi e në Maqedoni (të njohur edhe me emrat, si pomakë, torbeshë, babunë, mjakë, shopë, e edhe gogë), janë pjesë e një “Romanie në lëvizje”, e cila në hapësirën që e banojnë sot erdhën midis shek. X-XII, në kohën e Perandorisë së Bullgarisë, si barinj trakas së pari të romanizuar e më pastaj të bullgarizuar që në atdheun e tyre të kryehershëm, përkatësisht nga malet e Rodopeve të shtetit të sotëm të Bullgarisë. Goranët e Kosovës erdhën edhe nga Maqedonia e sotme, nga Greqia dhe nga Shqipëria e Jugut si vllahë heretikë/bogumilë të përndjekur nga kishat ortodokse bullgare dhe bizantine. Përkatësinë e kryehershme vllahe të goranëve e tregon ruajtja deri në ditë tonat e shumë emrave të vëllazërive, të mikrotoponimeve dhe

njësisve leksikore me prejardhje nga vllahishtja. Shumica dërrmuese e emrave me prejardhje latine-ballkanike, bizantine e sllave të goranëve ndeshen edhe te popullata shqiptare e krahinës fqinje të Opojës, me të cilën goranët ardhës bashkëjetuan (pa u bashkëshkrirë) që nga shek. X-XI e deri në ditë tonat. (Skënder Gashi)

GORANI Dukagjin (1967-). Gazetar, aktivist politik. Lindi në Pejë. Më 1993 ishte një ndër themeluesit e javores “Koha” dhe më pas i gazetës “Koha ditore” (1997). Më 1999 ishte kryeredaktor i gazetës në gjuhën angleze “Daily Times” në Prishtinë. Në periudhën 2000-2003 punoi drejtor i informacionit në “Kohavizion”, më pas themelues dhe kryeredaktor i gazetës “Express” (2005-2007). Mori pjesë në ekipin përcjellës të delegacionit kosovar në Konferencën e Rambujesë në Paris më 1999. Gjatë periudhës 2008-2013 ka shërbyer këshilltar i kryeministrit të atëhershëm të Kosovës, ndërsa më vonë ka qenë bartës i projektit për aktivizime politike. Ka gradën e doktorit të shkencave nga Universiteti i Kardifit. (Bardh Rugova)

GORANI Hajrullah (1931-). Ekonomist, profesor universitar, veprimtar sindikalist. Lindi në Pejë, ku mori shkollimin bazë, ndërsa u diplomua në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të



HAJRULLAH
GORANI

Beogradit (1965), ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Tezën e doktoratës e mbrojti më 1977 në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Karrierën akademike e filloi si asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas i mori të gjithë titujt universitarë. Fusha e punës së tij shkencore dhe profesionale lidhet me kontabilitetin dhe financat, pastaj me fushën e leksikografisë dhe me një sërë publikimesh me karakter arsimor. Ka botuar mbi 20 libra nga fusha profesionale e pedagogjike, ku bëjnë pjesë: “Teoria e bilancit” (1985), “Kontrolli, revizioni dhe analiza financiare” (1987), pastaj veprat leksikografike: “Fjalori i terminologjisë ekonomike” (1972), “Fjalori i termave dhe shprehjeve ekonomike” (1983), “Leksikon i vogël ekonomik” dhe “Fjalori i biznesit” (2006). Po ashtu ka botuar edhe

“Fjalorin e kontabilitetit (anglisht-shqip, shqip-anglisht)” (2008). Ka botuar punime shkencore në revista dhe gazeta të ndryshme. Në vitet pesëdhjetë u arrestua dhe u burgos nga regjimi i atëhershëm, me ç’rast u dënua me gjashtë vjet burg. Në vitet ‘90 ishte njëri ndër themeluesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, organizatë që i artikuloi kërkesat për të drejtat e punëtorëve dhe sensibilizoi opinionin e gjerë për gjendjen e rëndë të punëtorisë dhe të popullit shqiptar në Kosovë. (Arben Dermaku)

GORANI (Halim) Ismail (1902-1972). Veprimtar dhe luftëtar për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lindi në Davidovc të Shtimës. Si i ri u përfshi në jetën politike dhe më 1938 u zgjodh kryetar i komunës së Shtimes. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte nënprefekt i nënprefekturës së Ferizajt. Bashkëpunoi me Ilaz Agushin, Ferat Dragën, Ymer Berishën, Luan Gashin, Adem Gllavicën e shumë të tjerë, të cilët e luftuan komunizmin. Më 1944 mori pjesë në mbrojtjen e kufirit lindor të Shqipërisë etnike, si komandant, bashkë me Fuad Dibren e Shefqet Bylykbashin. Pas ripushtimit të Kosovës nga Jugosllavia, iu bashkua Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Në nëntor të vitit 1945, bashkë me shumë bashkëveprimtarë u arratis në Greqi, më pas në Turqi e pastaj në Damask të Sirisë, ku jetoi deri në vdekje. (Liman Rushiti).

GORANI Kujtim (1955-). Kërçyes në ujë, futbollist, gjimnast. Lindi në Gjakovë. Kërceu nga Ura e Fshejtë dhe Ura e vjetër e Mostarit. Nga Ura e Fshejtë ishte kampion i Kosovës 10 herë radhazi, ndërsa nga Ura e vjetër e Mostarit (Bosnjë e Hercegovinë), që nga viti 1969 deri në vitin 1983 mori pesë herë vendin e tretë, shtatë herë vendin e dytë dhe dy herë ishte kampion i ish-Jugosllavisë. U mor edhe me futboll. Ishte portier i përfaqësueses së Kosovës në kategorinë e të rinjve. Merrej edhe me gjimnastikë dhe një herë ishte shpallur kampion i Serbisë së atëhershme. Në vitin 2009 ai u rikthye në Urën e Mostarit (të rikonstruktuar), duke kërçyer sërish nga lartësia 30 m. Vazhdon kërcimet nga Ura e Fshejtë. (Moral Pozhegu)

GORANI Talat (1924-). Mjek, pediatër. Lindi në Prizren, shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në qytetin e lindjes. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të

Zagrebit (1958). Pas diplomimit u kthye të punojë në vendlindje. Specializoi në lëmin e pediatriisë në Beograd dhe në Shkup. Punoi në Repartin e Pediatriisë të Spitalit të Përgjithshëm në Prizren. Me emrin e tij lidhet ngushtë zhvillimi i shërbimit pediatrik në Prizren dhe në mbarë Kosovën. publikoi disa punime profesionale, bazuar në përvojën e tij të pasur si mjek pediatër. (Mujë Shala)

GORAZHDECI. Fshat në komunën e Pejës, rreth 7 km në lindje të qytetit. Është vendbanim i tipit të dendur. Shtrihet në lartësi mbidetare 490 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 9.7 km², nga e cila rreth 84% janë sipërfaqe bujqësore, 11% pyje dhe 5% zonë e ndërtuar. Sipas regjistrimit të fundit (2011) numri i popullsisë është 570 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore dhe stacionin shëndetësor. (Idriz Shala)

GOXHAI Dilaver (1948-). Oficer karriere, pjesëmarrës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Gjirokastrë. Pasi kreu shkollën e mesme ushtarake u specializua për raketa të drejtuara kundërajrore. Në vitet 1982-1984 përfundoi Akademinë Ushtarake dhe u emërua pedagog në këtë akademi. Në vitet 1985-1987 përfundoi kualifikimin pasuniversitar dhe u avancua në poste të rëndësishme në Ushtrinë Shqiptare. Në tetor të vitit 1993 u gradua kolonel, ndërsa një vit më vonë nxirret në rezervë. Në fillim të muajit mars 1999 shkoi vullnetar në UÇK, ku i ngarkohet detyra e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe oficer i mbajtjes së bashkëveprimit me aviacionin e NATO-s. Në mbarim të luftës në Kosovë, në qershor 1999 u emërua shef i kabinetit të ministrit të Mbrojtjes të Qeverisë të Përkohshme të Kosovës deri në janar të vitit 2000. Më pas u kthye në Tiranë. Është autor i disa librave publicistikë dhe letrarë për luftën e UÇK-së: “Rruga që më çoi në radhët e UÇK-së”, “Romantika e luftës së UÇK-së”, “Komandanti i pararojës”, “Drama e UÇK dhe e Adem Demaçit” etj. (Xhevat Bislimi)

GRABOVCI Adem (1960-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), politikan. Lindi në Staradran të komunës së Istogut. Kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës aktiv i demonstratave të vitit 1981. Në periudhën

1984-1989 ishte i dënuar me burg, për veprimtari politike. Në fillim të viteve '90 ishte njëri ndër nismëtarët e pajtimit të gjaqeve, si dhe veprimtar për rikthimin e të shpërngulurve nga Kosova. Ishte anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPRK-LPK). Më 1991 emigroi në Zvicër, ku e vazhdoi aktivitetin politik. U zgjodh kryetar i degës së LPK-së në Zvicër dhe anëtar i kryesisë qendrore të LPK-së. Ishte njëri ndër themeluesit e fondit "Vendlindja thërret" dhe i UÇK-së, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe shef i G1 (Drejtorisë Personale). Pas luftës kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e vendit. Ishte njëri ndër themeluesit e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe njëri nga sekretarët e saj, më pas nënkryetar i kësaj partie. Që nga zgjedhjet e vitit 2007 është deputet i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i grupit parlamentar të PDK-së në dy mandate. (Ruzhdi Jashari)

GRABOVCI Arbër (1970-). Futbollist, trajner, gazetar i sportit. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Prishtinës. Karrierën e futbollistit e filloi që në moshën 9-vjeçare, duke kaluar nëpër të gjitha kategoritë e KF "Buduqnosti" nga Peja, skuadër më të cilën luajti edhe deri në ligën e tretë të ish-Jugosllavisë. Për një kohë ishte edhe kapiten i kësaj skuadre në kategorinë e të rinjve. Pas pavarësimit të sportit të Kosovës kaloi te KF "Besa" e Pejës, pastaj te skuadrat prishtinase "Flamurtari", "2 Korriku" dhe "Elektroekonomia". Pas përfundimit të karrierës aktive një kohë punoi si trajner dhe më vonë si gazetar dhe redaktor i sportit në Radio-Dukagjini. Në vitin 2001, me hapjen e "TV Dukagjinit", krijoi redaksinë e sportit në këtë medium. Nga viti 2007 është kryeredaktor i "TV Dukagjinit". Për 15 vjet rresht ka komentuar ndeshjet e futbollit, të basketbollit dhe të hendbollit kosovar. Ka shkruar edhe për gazetat e përditshme "Epoka e re" dhe "Info-press". (Gani Kosumi)

GRABOVCI Shaip (1936-). Dramaturg, gazetar. Lindi në Pejë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërkaq Shkollën Normale në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Botoi mbi 30 drama për të rritur dhe për fëmijë, ndër të cilat: "Unë në botën e



SHAIP GRABOVCI

dhe Xheri", "Lajthimi", "Ëndrra e Lulit", "Besimi i humbur" (katër drama për fëmijë), "Kënga si dhuratë" etj. Dramat e tij janë vënë në skenë në Teatrin Popullor Krahinor, më pas në Teatrin "Dodona", në Teatrin Shqiptar në Shkup, në Teatrin e Pejës, në Teatrin e Mitrovicës etj. Përveç si autor dramash, njihet edhe si autor i tregimeve humoristike, të cilat i botoi në librin "Macja në dritare". Punoi si gazetar dhe kryeredaktor në Radio Prishtinë, në gazetën "Rilindja" dhe në RTV 21. (Naime Beqiraj)

GRABOVCI Tomor (1973-). Gazetar i sportit. Lindi në Pejë. Hapat e parë në gazetari i bëri menjëherë pas luftës në të përditshmet "Daradania press" dhe "Dita". Më pas kaloi në RTV 21 dhe Radio-Dukagjini, fillimisht si gazetar e më pas redaktor. Punoi edhe në "TV Dukagjini", gazetar dhe bartës i emisioneve sportive. Ka komentuar për 15 vjet rresht ndeshjet e futbollit, basketbollit dhe të hendbollit të Kosovës, por edhe ndeshjet e kombëtares shqiptare dhe të kombëtares së Kosovës. Ka raportuar nga vendi i ngjarjes për shumë zhvillime ndërkombëtare në basketboll dhe në boks, ku ka marrë pjesë edhe përfaqësuesja e Kosovës. (Gani Kosumi)

GRAÇANICA. Shtrihet në juglindje të Prishtinës, rreth 7 km nga qyteti. Është vendbanim i tipit të grumbulluar, me sipërfaqe prej 1,319 ha. Banohet kryesisht nga popullsia serbe. Në ngastrën e këtij vendbanimi janë gjetur shumë mbishkrime të periudhës antike. Manastiri i Graçanicës u ndërtua në fillim të shekullit XIV, mbi gërmadhat e një kishe të vjetër. Nga dokumentet e shkruara, fshati përmendet në kartën e Graçanicës të vitit 1321. Si vendbanim me këtë emër është i regjistruar në një hartë austriake të vitit 1689. Në vitin 1893 kishte 60 shtëpi serbe me më tepër se 400 banorë. Sipas B. Nushiqit, rreth vitit 1900 ishin 59 shtëpi serbe me 421 banorë, por edhe disa



GRAÇANICA

shtëpi shqiptare. Në vitin 1905 kishte 59 shtëpi serbe, 5 shqiptare (muhaxhirë) dhe 13 rome, ndërsa në vitin 1912 ishte një ndër vendbanimet e mëdha në Kosovë, me 63 shtëpi serbe dhe 15 shtëpi shqiptare. Në vitin 1948 kishte 160 shtëpi me 1,087 banorë, ndërsa në vitin 1981 kishte 910 shtëpi me 4,529 banorë. Nëpër Graçanicë kalon rruga rajonale Prishtinë-Gjilan, ndërsa përmes Laplasellës lidhet me magjistralen Prishtinë-Shkup. Nga objektet e standardit shoqëror ka objektin e administratës komunale, stacionin shëndetësor, spitalin, disa objekte shërbyese dhe tregtare etj. Në juglindje të Graçanicës ndodhet vendbanimi antik i Ulpianës. (Nazif Gashi)

GRAÇANICA (komuna). Komuna e Graçanicës u themelua në vitin 2008 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas planit të Ahtisarit mbi decentralizimin. Shtrihet në afërsi të rrugës Shkup-Prishtinë dhe Prishtinë-Gjilan. Bashkon 15 fshatra të banuara kryesisht me popullatë serbe. Komuna e re është formuar, duke shkëputur pjesë të territoreve të komunës së Lipjanit, të Fushë-Kosovës dhe të Prishtinës. Në juglindje dhe lindje kufizohet me komunën e Lipjanit, në perëndim kufizohet me komunën e Fushë-Kosovës, kurse në veri me komunën e Prishtinës. Sipas vlerësimit të Entit Statistikor të Kosovës në vitin 2011 komuna e Graçanicës ka pasur rreth 10,871 banorë. Sipas këtij vlerësimi struktura etnike e popullsisë është si vijon: 85% serbë, 3.7% shqiptarë dhe 10.6% të tjerë. Komuna e Graçanicës ka kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë. Nga objektet e standardit shoqëror, Graçanica ka një shkollë fillore, dy shkolla të mesme, disa dyqane të vogla, një treg të hapur, qendrën shëndetësore etj. Në dhjetor të vitit 2008 qeveria serbe financoi ndërtimin

e një zyre të postës, ndërsa në vitin 2014 Qeveria e Kosovës ndërtoi objektin e komunës së Graçanicës në qendër të këtij vendbanimi. Territorin e komunës së Graçanicës e përbëjnë këto vendbanime: Badovci, Batusa, Dobratini, Graçanica, Gushterica e Poshtme, Gushteriva e Epërme, Laplesella, Lepinja, Livagja, Preoci, Skulaneva, Sushica, Suvi Dol, Radeva, Uglari dhe Kishnica. (Nazif Gashi)

GRADASHÇEVIQ (Gradašćević) Huseinbeg (1802-1834). Udhëheqës i ajanëve të Bosnjës kundër reformave të sulltan Mahmudit II. Lindi në Gradaçac të Bosnjës dhe nga viti 1821, kur erdhi në krye të kapetanisë së Gradaçacit filloi të njihej në popull me emrin Kapetan Gradashçeviq. Disfata e osmanëve në luftë kundër Rusisë (1828-1829) rezultoi me kundërshtimin e vendosur të bejlerëve boshnjakë kundër reformave të sulltan Mahmudit II. Në fillim të vitit 1831 u zgjodh nga paria boshnjake për udhëheqës të kryengritjes boshnjake për autonomi, më pas futi në dorë Travnikun dhe, në marrëveshje me Mustafa Pashë Bushatliun, po atë vit mposhti ushtrinë osmane në Kosovë. Në betejën te Lipjani, ushtria osmane pësoi disfatë edhe për faktin se pjesa më e madhe e saj përbëhej nga ushtarë shqiptarë të anës së Prizrenit, të udhëhequr nga Mahmud Pashë Rrotlla, të cilët iu bashkuan boshnjakëve. Ushtria e Gradashçeviqit pastaj kaloi në Rrafshin e Dukagjinit, ku u implikua në mbrojtjen e krahut autonomist të Mahmudbegollëve, i përfaqësuar nga Hasan Pasha. Boshnjakët e Gradashçeviqit qëndruan në Pejë deri në pjesën e dytë të korrikut 1831. Gradashçeviqi e shpalli veten vezir dhe kërkoi nga sulltani t'i ndalonte reformat në Bosnjë, por sulltani as e pranoi titullin e vetëshpallur, as kërkesën për autonomi administrative të Bosnjës. Veziri osman Mehmet Reshid Pasha, pasi mblodhi rreth vetes parinë e Hercegovinës, kundërshtarë të Gradashçeviqit, e theu ushtrinë boshnjake pranë Sarajevës. Në ushtrinë e tij prej 30 mijë vetash mori pjesë edhe paria e Kosovës me mbi 10 mijë shqiptarë. Pas kësaj disfate, Gradashçeviqi u detyrua të kërkonte strehim në Austro-Hungari. Me ndërhyrjen e kancelarit të Austrisë, Meternih, u fal nga sulltani, por pa të drejtë kthimi në Bosnjë. Vdiq në rrethana të panjohura në Stamboll. Figura e tij njihet si figurë legjendare e historisë boshnjake. (Gazmend Rizaj)

GRADAT SHKENCORE DHE TITUJT UNIVERSITARË. Tradicionalisht, ekzistojnë dy grada shkencore: doktor i shkencave dhe magjistër (master) i shkencave. Në vende të ndryshme kanë kuptime të ndryshme, ndërsa në Kosovë, sipas Deklaratës së Bolonjës, pas studimeve trevjeçare për baçelor, vijon grada shkencore master i shkencave dhe kulmon me gradën më të lartë, atë të doktorit të shkencave. Tituj universitarë tradicionalisht kanë qenë: docent, profesor inordinar dhe, titulli më i lartë, profesor ordinar. Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën Kosovës (2011), për stafin akademik të universiteteve dhe kolegjeve universitare në Kosovë, parashihen këta tituj universitarë: profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent, asistent universiteti. Për raste të caktuara parashihen edhe tituj të tjerë. Kriteret për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancime për tituj universitarë përcaktohen në statutin e bartësit (institucionit) të arsimit të lartë, gjithnjë në harmoni me legjislacionin përkatës. (Majlinda Gjellaj)

GRADICA Mehmet (1909-1945). Nacionalist dhe luftëtar antikomunist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Gradicë të Drenicës. Në moshën 15-vjeçare arrestohet nga organet e pushtetit serb, por arratiset nga burgu dhe ik në Shqipëri. Në vitin 1941 u kthye në vendlindje dhe u caktua postkomandant i xhandarmërisë në Podujevë, Mitrovicë, Stantërg, Vushtrri dhe, së fundi, në Skënderaj. U angazhua në luftimet për mbrojtjen e kufirit nga Serbia dhe Mali i Zi gjatë periudhës 1941-1944. Më pas u inkuadrua në regjimentin "Kosova", për të luftuar kundër komunistëve. Mbështeti dhe mori pjesë aktive në Lidhjen e Dytë të Prizrenit. I tejkaloi mospajtimet me Shaban Polluzhën dhe ai ia besoi komandën për udhëheqjen e qëndresës në Drenicë. Në përballje me njësitet partizane u plagos rëndë nga gjylja e topit më 21 shkurt 1945, edhe pse arriti ta shpërthente rrethimin. Vdiq nga plagët po atë ditë që u vra edhe Shaban Polluzha, në afërsi të shkollës së Dobroshecit. (Muhamet Shatri)

GRADINA E BARDHIT TË MADH (BELLAQEFC). Vendbanim i fortifikuar kodrinor i epokës së hekurit. Gjetet mbi kodërzën buzë anës së djathtë të lumit Drenica, në perëndim të fshatit dhe në jugperëndim të Fushë Kosovës. Ka formë trapezi jo të rregullt (124 x 123 m)

dhe fortifikohej në të gjitha anët me ledhe dhe, rëre e gurësh (1.2 ha). Përgjatë anës veriore e perëndimore nga brenda ruhen ledhet e larta 2-4 m dhe nga jashtë 3-6 m. Rrëzë ledheve gjendet hendeku mbrojtës (120 x 3-5 m) me thellësi deri në 2 m. U banua në epokën e neolitit të hershëm dhe bronzit të vonë, por zhvillim të hovshëm arriti gjatë epokës së hekurit (shek. VIII-V p.e.r.). Neoliti i hershëm përfaqësohet nga qeramika impreso e barbotine dhe thikat e strallit, ndërsa epoka e bronzit të vonë nga fragmente të enëve të mëdha bikonike, pjata të thella konike dhe zbukurime të shiritave me bigël e thimtha konik. Për fazën e parë të epokës së hekurit (VIII-VI p.e.r.) veçohen qypat dykonikë, enët më një e dy vegje dhe taset me zbukurim kryesisht me instrument të dhëmbëzuar e motive të tjera. Kësaj faze i takon dhe instrumenti i dhëmbëzuar i punuar nga argjila, i cili shërbente për zbukurim të enëve. Në fazën e dytë të epokës së hekurit përsëriten disa forma të fazës së parë dhe shfaqet qeramika e punuar në çark. Në të dy fazat janë të pranishme objektet metalike dhe banesat e ngritura mbi tokë me rrasa gurësh. (Haxhi Mehmetaj)

GRADINA E CERNICËS. Vendbanim kodrinor i fortifikuar i epokës së hekurit. Gjetet te fshati Cërnice, rreth 2 km në të majtë të rrugës Ferizaj-Gjilan. Ka pozitë të mirë gjeostrategjike, të rrethuar me tokë pjellore (600 m). Vendbanimi ka formë të trekëndëshit jo të drejtë (141 x 172 x 107 m), me mbrojtje natyrore të rënies së prerë vertikale në verilindje dhe e kufizuar me një luginë në veriperëndim dhe juglindje. Në të u zhvilluan gërmime arkeologjike nga Muzeu i Kosovës (1969) dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës (2014), me ç'rast u konstatua se vendbanimi u banua gjatë shek. VIII-IV p.e.r. Në shtresat e shek. VIII-VI p.e.r. dominon qeramika e punuar me dorë dhe e dekoruar me instrument të dhëmbëzuar, ndërsa nga shek. VI p.e.r. paraqitet dhe qeramika vendore e punuar në çark të poçarit, si dhe qeramika e importuar nga bota mesdhetare. (Premtim Alaj)

GRADINA E GADIMES SË EPËRME. Vendbanim kodrinor shumështrësor, në lindje të fshatit Gadime e Epërme (Lipjan). Gjetet mbi kodër me anë të pjerrëta, pos asaj lindore, të lidhur me lug me prapavijën kodrinore,



GRADINA E GADIMES

ndërsa rrëzave jugperëndimore rrjedh një lumë. Banorët e parë ishin indoeuropianët e epokës së eneolitit (kultura Bubanj-Hum, Tarraca I), kur edhe u rrethua me ledhe dheu. Epokës i takojnë idolet në trajtë pete të zgjatur, enët dyvegjëshe që dalin nga buzët, ornamentimi relievor me kanelyra e spirale dhe përdorimi i grafitit. Banorët e njohur ishin dardanët (kultura e Gllasinacit, Tarraca I, II). Qeramika e shek. VIII-VI ka enë me buzë të kthyer brenda, njëvegjëshe buzëdala, dyvegjëshe, tase njëvegjëshe dhe enë të thella me buzë të dala. Dominon zburimi i gërryer me mjet të dhëmbëzuar. Në shek. VI-IV (faza paraurbane) vendbanimi u zgjerua në pjesën perëndimore, i cili u rrafshua në mënyrë të organizuar (Tarraca II). Fazës paraurbane i takojnë bazat e godinave katërkëndëshe, me bazamente gurësh të shtyllave të drurit, modeli miniaturë i shtëpisë etj. Enët u punuan në çark, me trajta vendëse dhe me modele helene (skifosë, kilikë, kantarosë, hidria, lekanë, kraterë, pitosë, amfora) dhe u pikturuan me breza horizontale dhe të lakuar me motive bajameje. Unike është ena me mbishkrim të alfabetit arkaik grek (shek. VI p.e.r.), shkronja M në enën tjetër, si dhe qeramika e stilit Wave-Line (shek. VI p.e.r.) dhe e tipit Saint Valentin (fund. shek. V-fill. shek. IV p.e.r.). Rrëzë kodrës gjendet një vendbanim i vogël i periudhës romake. U gërmua nga Muzeu i Kosovës (1974, 1975). (Edi Shukriu)

GRADINA E HEREQIT. Vendbanim kodrinor i epokës së hekurit. U ndërtua mbi një kreshtë shkëmbore, në jug të fshatit Hereq të Gjakovës, pranë anës së djathtë të rrugës Gjakovë-Deçan (50 a). Njihet dhe me emrin “Sukë”. Ka formë eliptike dhe mbrohet me dy

parë ledhe të ngritura më gurë në teknikë të thatë. Linjat e ledheve ndodhen në distancë 22-24 m nga njëra-tjetra, me diametër të vogël prej 50 m dhe diametër të madh 110 m. Mënyra e fortifikimit është tipike për kalatë ilire të epokës së hekurit. (Haxhi Mehmetaj)

GRADINA E LLAPUSHNIKUT. Vendbanim i fortifikuar kodrinor, i banuar nga parahistoria deri në antikën e vonë. U vendos në kreshtë të lartë shkëmbore, mbi fshatin Llapushnik dhe ka pozitë dominante strategjike mbi hapësirën e Drenicës. Komunikon me gradina të shumta, si atë të Vuçakut në afërsi, Veletinit në fushën e Kosovës e deri te ajo e Zatriqit në Rrafshin e Dukagjinit. Pjesa më e lartë e gradinës njihet me emrin “Shkambi i Gradinës” dhe ka trajtë të një platforme të shkallëzuar (27-30x13-18 m). Në anën veriore gjendet muri i lartë që bashkon dy shkëmbinj të natyrorë, të vendosur 24 m larg njëri-tjetrit. Vendbanimi është fortifikuar me ledh mbrojtës, ndërsa në antikitetin e vonë u ngrit edhe muri i dytë rrethues. Mbështetur në fragmentet sipërfaqësore të enëve dhe në strukturat e mureve, vendbanimi u banua në epokën e vonë të bronzit (shek. XIII-XII p.e.r.), epokën e hekurit (shek. XI-IV p.e.r.) dhe në antikën e vonë (shek. IV-VI). (Premtim Alaj)

GRADINA E PEJËS. Vendbanim i periudhës romake në periferi të Pejës. Shtrihet në hapësirë të sheshtë përgjatë Bisticës së Pejës, në arealin e Fabrikës së Baterive, karakteristike kjo për vendbanimet e fazës së stabilitetit të Perandorisë Romake. Më 1978, gjatë ndërtimit të Fabrikës së Baterive u zbuluan gjurmë të disa objekteve dimensionesh të ndryshme, që u klasifikuan si “horreum”. Janë evidentuar dhe gjetje të tjera, ndër të cilat monedha të shek. IV dhe disa stela. Disa studiuues e ubifikojnë si qytetin Siparuntum, të shënuar nga Ptolemeu. Afër gjendej dhe kampi ushtarak i antikës së vonë, i evidentuar edhe me planimetri nga studiuesi hungarez A. Budaj. (Arben Hajdari)

GRADINA E PIDIQIT. Vendbanim kodrinor parahistorik dhe antik. Ndodhet në zonën e Karadakut, mes fshatrave Shurrdhan dhe Pidiq. Është ngritur mbi kreshtë shkëmbore, në pjesën më të lartë të së cilës ruhen gjurmët e një kulle. Kulla është ndërtuar nga gurë të lidhur me llaç gëlqeror (2 x 1.5 m), si dhe muri rrethues e objektet përcjellëse. Gradina e

Pidiqit, mbështetur në materialin arkeologjik dhe arkitektonik, është banuar nga epoka e bronzit të vonë, epoka e hekurit e deri në antikitetin e vonë. Gërmimet arkeologjike u zhvilluan nga Muzeu i Kosovës (1983). (Kemajl Luci)

GRADINA E VUÇAKUT. Vendbanim kodrinor parahistorik, i antikës së vonë dhe i mesjetës. Gjendet në pozitë dominuese mbi fshatin Vuçak (930 m), rreth 12 km në jugperëndim të Drenasit. Përbëhet nga Gradina e Madhe dhe Gradina e Vogël, që lidhen midis tyre përmes një qafe të ulët në trajtë shale. Mbi vendbanimin parahistorik është vendosur ai i antikës së vonë dhe në të ruhen gjurmë muresh të ndërtuar me gurë përmasash mesatare dhe të lidhura me llaç gëlqeror të cilësisë së dobët. Muri arrin gjerësinë 2.20-2.40 m, duke krijuar një linjë planimetrike eliptike me kalime të buta në kënde e kthesa. Perimetri i tarracës është 228 m, ndërsa gjatësia e trakteve të mureve arrin 118 m. Muri plotëson strukturën me shkëmbinj të shkëputur natyrorë, të cilët gjenden në linjën e murit në anën veriore në gjatësi prej 25 m. Hyrja e kalasë gjendet në anën verilindore, me gjerësi 4-5 m. Në sipërfaqen e brendshme shihen rrënoja të shumta muresh të lidhura me llaç gëlqeror, që u takojnë godinave të tjera të shek. VI. Gradina ka komunikim vizual me Gradinën e Lladroviqit dhe të Llapushnikut në jug, Gradinën e Kijevës në perëndim dhe malin e Shishavicës në lindje. (Arben Arifi)

GRADINA. Toponim i vendbanimeve kodrinore. Etimologjia lidhet me gjuhën indoeuropiane, pasi vendbanimet fillimisht u rrethuan me gardh. U ndërtuan në kodra të larta dhe të ulëta, me pozitë gjeostrategjike dominuese. Gradinat e para lidhen me epokën e eneolitit të hershëm, kur popullata fushore neolitike u vendos në kodra, për shkak të nismës së veprimtarisë xehetare (Vallaç). Faza e dytë lidhet me dyndjet indoeuropiane, pasigurinë e krijuar dhe vendosjen e banorëve të rinj, bartës të kulturës Bubanj-Hum në Kosovë. U banuan deri në epokën e hekurit dhe jeta në disa prej tyre u shua në shek. IV p.e.r. (Gadime e Epërme, Bardh i Madh, Cernicë etj.), ndërsa në të tjerat kishte vazhdim jete deri në mesjetë (Veletin, Vlashnjë, Kasterc, Teneshdoll, Duboc, Korishë, Hisar të Suharekës etj.). Si rezultat i kësaj vazhdimësie toponimi ndryshoi në

Gradishtë dhe më pas në gjytet, qytezë, kala, çukë, sukë, sukal e hisar. Toponimi ndeshet dhe si vendbanim fushor vetëm në periudhën romake (Ulpianë, Gushicë e Vitisë). (Pleurat Kabashi)

GRADISHA E GEXHËS. Vendbanim kodrinor shumështrësor me kohështirje nga epoka e bronzit deri në antikën e vonë. Njihet dhe me toponimin Kalaja e Gexhës dhe është ndërtuar sipër kanionit të Drinit të Bardhë, në anën e majtë të lumit të fshati Gexhë (Rahavec), rreth 500 m në veri të Urës së Fshejtë. Ka pozicion të mirë gjeostrategjik, me fortifikim të zhvilluar në anën veriore dhe veriperëndimore përgjatë tarracës së sheshtë, e cila shtrihet deri mbi shkëmbinj të thepisur të kanionit të Drinit të Bardhë, që përbën mbrojtjen natyrore. Fortifikimi ka trajtë gati trapezoide (150 x 90 m) dhe, pos mureve mbrojtëse, kishte edhe kulla. Si i tillë, ka elemente të qarta të një kastrumi, që mund të jetë ndërtuar në kohën e tetrarkisë (shek. IV), duke u shfrytëzuar gjatë gjithë antikitetit të vonë. Komunikonte në linjë ajrore me disa fortifikime të tjera, në perëndim me Sukën e Cërmjanit, Kodrën e Hereqit, Gradinën e Gurit të Kuq dhe në verilindje me Gradishtën e Zatriqit. (Milot Berisha)

GRADISHA E VLASHNJËS. Vendbanim parahistorik, antik dhe mesjetar. Shtrihet në sipërfaqen e sheshtë të kodrës së ulët të tarracës lumore midis Lumëbardhit të Prizrenit dhe përroit të Vlashnjës, në anën e djathtë të rrugës Prizren-Morinë. Ka pozitë të favorshme gjeostrategjike, duke kontrolluar perëndimin e fushës së Prizrenit, ku në prehistori kalonte rruga që lidhte Adriatikun me Ballkanin Qendror, ndërsa në periudhën romake rruga Lissus-Naissus. U identifikua në vitet '60 dhe në literaturën arkeologjike zuri vend në vitet '70 të shek. XX. Gërmimet e para u organizuan nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Muzeun e Kosovës (2002) dhe më pas nga Instituti Arkeologjik i Kosovës (2006-2010), të cilët kanë pasqyruar një kronologji të qartë të vendbanimit. Janë identifikuar gjithsej shtatë nivele banimi: Vlashnja Ia-b (neoliti i hershëm: Starçevo Ila-b), Vlashnja Ila (neoliti i mesëm, Vinça-Tordosh I), Vlashnja I Ib (neoliti i vonë: Vinça-Ploçnik I e Danilo-Reshtan), Vlashnja III (eneoliti: Bubanj Hum Ib), Vlashnja IVa (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVb (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVc (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVd (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVe (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVf (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVg (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVh (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVi (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVj (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVk (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVl (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVm (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVn (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVo (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVp (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVq (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVr (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVs (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVt (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVu (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVv (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVw (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVx (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVy (bronzi i i hershëm), Vlashnja IVz (bronzi i i hershëm).

mesëm), Vlashnja IVc (bronzi i vonë), Vlashnja Va (periudha subgjeometrike e arkaike: shek. VII-VI p.e.r.), Vlashnja Vb (periudha klasike: shek. V p.e.r.), Vlashnja Vc (shek. IV-I p.e.r. [?]), Vlashnja VI (periudha romake: shek. I-IV), Vlashnja VII (antika e vonë: V-VI). Vlashnja shquhet me fazat suksesive të jetës gjatë tri fazave të periudhës së bronzit dhe asaj klasike-helenistike, periudha që mundësojnë njohjen e formimit dhe zhvillimit të vazhdimësisë së popullsisë iliro-dardane, si dhe kohën kur lidhet edhe formimi i shtetit dardan. (Shafi Gashi)

GRADISHA. Toponim i vendbanimeve kodrinore të ulëta, i banuar edhe në periudhën romake. Variantet e saj të ruajtura janë dhe “Gradishta” e “Gadisha”, të cilat lidhen me toponimin Gradina të vendbanimeve eneolitike. (Pleurat Kabashi)

GRAFIKA. Zhvillimet e para të grafikës në Kosovë lidhen me hapjen e institucionit të parë arsimor artistik, me Shkollën e Mesme të Arteve Aplikative në Pejë, në vitin 1948. Kontribut të



PAMJE NGA ÇELJA E NJË EKSPOZITË NË GALERINË E ARTEVE TË KOSOVËS

veçantë për themelimin e saj dhanë dy piktorët nga Kosova, Shahin Kryeziu dhe Vllada Radoviqi. Gjatë viteve të para të veprimtarisë së kësaj shkolle, krijohen dhe grafikët e para. B. Prodanoviqi promovon ciklin e grafikave të realizuara në teknikën e bakërshkrimit me motive kosovare. Po ashtu Skënder Hoxha

boton në shtyp grafikët e tij në teknikën e drugdhendjes, bardh-zi, me motivet e qyteteve të Kosovës. Zhvillimit të mëtejshëm të grafikës i kontribuon edhe hapja e ekspozitës personale e Muslim Mulliqit, me piktura dhe grafikë, në vitin 1952 në Gjakovë. Grafika në teknikën e drugdhendjes dhe gjilpërës së thatë krijuan dhe Nuredin Loxha, Shemsedin Kasapolli dhe Tahir Emra. Në vitin 1962, në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë filloi punën grupi studimor i arteve figurative, me një kuadër akademik të profilizuar: Muslim Mulliqi, Svetomir Arsiq, Tahir Emra, Gjëlosh Gjokaj, Hilmija Qatoviq, Nikolla Gvozdenoviq dhe Shemsedin Kasapolli. Themelimi i kësaj shkolle ishte bazë për zgjerimin e njohurive në lëmenjtë e arteve figurative, në veçanti të grafikës. Në vitin 1964 piktori dhe grafiku Gjëlosh Gjokaj, i cili ligjëronte në Shkollën e Lartë lëndën e vizatimit dhe të grafikës e sjell për herë të parë nga Lubjana në Kosovë presën grafikë për shtyp të thellë. Grafika me teknikën e akuatintës dhe të bakërshkrimit krijoi dhe grafiku e piktori Trajko Stojanoviq, gjatë viteve '70, i frymëzuar nga freskat dhe ikonat kishtare. Në vitin 1973 u themelua Akademia e Arteve, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, me tri degët e arteve figurative: pikturë, skulpturë dhe grafikë. Në kuadër të këtij institucioni të lartë arsimor, në vitin 1974/75, për mësim në gjuhën shqipe në drejtimin e grafikës u zgjodhën ligjërues Fatmir Krypa, asistent Hysni Krasniqi dhe në gjuhën serbokroate ligjërues Zoran Jovanoviq, të specializuar më parë në akademitë e arteve të Beogradit, të Zagrebit dhe të Lubjanës. Më pastaj u zgjodhën ligjëruesit Xhevdet Xhafa dhe Shaip Çitaku për lëndën grafikë. Pas katër vjetësh dhe në vijim u diplomuan gjeneratat e para të grafistëve të talentuar, të cilët, krahas me pedagogët e tyre, merrnin pjesë në ekspozita të grafikës në Kosovë dhe në qendra të ish-Jugosllavisë dhe jashtë saj. Në ekspozitën “Grafika jugosllave 1950-1980”, Kosova u prezentua me 11 grafistë: Gjëlosh Gjoka, Shyqri Nimani, Fatmir Krypa, Hysni Krasniqi, Zoran Jovanoviq, Shaip Çitaku, Agim Salihu, Rustem Bujupi, Hamdi Terziqi, Fatmir Zajmi dhe Karmon Fan Ferri. Kjo ekspozitë u paraqit në të gjitha republikat dhe krahinat e ish-Jugosllavisë, nga tetori i vitit 1985, deri në tetor të vitit 1986, duke afirmuar kështu artin e grafikës kosovare. Përveç kësaj, rol të rëndësishëm në afirmimin e mëtejshëm të grafikës në Kosovë dhe më gjerë

luajti edhe themelimi i Galerisë së Arteve të Kosovës, në vitin 1979. Ajo krijoi një fond të pasur të veprave artistike, në veçanti të atyre grafike, me të cilat u prezentua me shumë sukses grafika e krijuesve kosovarë së pari në Prishtinë dhe pastaj në disa qytete të ish-Jugosllavisë: në Dubrovnik, Zagreb, Lubjanë, por edhe në Palermo, Damask, Munihi, Londër etj. (Fatmir Krypa)

GRAINCA Ibrahim (1916-1986). Pjesëmarrës në lëvizjen antifashiste dhe në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Cërnillë të Ferizajt. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u përfshi në lëvizjen antifashiste. Nga fundi i nëntorit 1944 u emërua komandant i rojës partizane dhe më pas u zgjodh kryetar i komunës në Babushin serb. Në prill të vitit 1945 ishte anëtar i delegacionit të shqiptarëve që shkoi në Beograd për t'u takuar me Josip Broz Titon. Më pas mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Krahinor Nacional Çlirimtar të Kosovës, që u mbajt në Prizren, më 8-10 korrik 1945, ku u shpreh kundër aneksimit të Kosovës nga Serbia. Në vjeshtën e po atij viti iu bashkohet forcave nacional-demokratike që kishin filluar të organizoheshin në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Ishte njëri ndër organizatorët dhe delegat i Kongresit të LNDSH-së në Blinajë (ish-Lipovicë). Në fund të vitit 1946 u arrestua, së bashku me shumë veprimtarë të LNDSH-së, dhe u dënua me 20 vjet burg, prej të cilave 9 vjet i vuajti në burgun e Mitrovicës së Sremit. (Muhamet Shatri)

GRAINCA Nafije (1955-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë. Mbaroi studimet në degën e gazetarisë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (1979). Nga viti 1976 deri në vitin 1979 ishte gazetare në gazetën e studentëve të Universitetit të Prishtinës "Bota e re". Më pas, nga viti 1979 deri në vitin 2002 punoi gazetare dhe redaktore në të përditshmen "Rilindja", në rubrikën e kulturës. Shkroi kryesisht nga fusha e kulturës: lajme, artikuj, vështrime etj. Bashkëpunoi me revistën "Kosovarja" dhe gazetën "Iliria post". Punon në departamentin e promovimeve në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit. (Veli Bytyçi)

GRAJÇEVCI Fadil (1963-). Studiues i letërsisë. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Ndoqi studime në degën e

letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Universitetin e Prishtinës. Më pas kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës për poezinë e Esad Mekulit. Që nga viti 1988 filloi punë si punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e letërsisë. Ishte anëtar i redaksisë së revistës shkencore "Gjurmime albanologjike", seria e shkencave filologjike. Ka dhënë ndihmën e tij në përgatitjen dhe botimin e materialeve që kanë rrjedhur nga konferencat dhe sesionet e ndryshme shkencore të mbajtura në këtë institut. Veprat e botuara: "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XV" (1998), "Vepra letrare e Esad Mekulit dhe kritika e saj" (2013). (Kujtim Rrahmani)

GRAJÇEVCI Florim (1964-). Inxhinier i ndërtimitarisë, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë. Shkollimin e kreu në Prishtinë, studimet për ndërtimtarin i përfundoi në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i filloi në Universitetin e Zagrebit dhe i përfundoi në UP. Studimet e doktoratës i vazhdoi në Gjermani, në Universitetin e Bohumit. Punën pedagogjike në UP e filloi në vitin 1990 si asistent, më pas ligjërues, profesor asistent dhe më 2015 profesor i asociuar. Mori pjesë në kongrese dhe seminare shkencore, simpoziume dhe konferenca profesionale dhe kreu punë të tjera profesionale në cilësi të projektuesit, të mbikëqyrësit, të udhëheqësit të punimeve ndërtimore dhe të verifikuesit. (Misini Misini).

GRAJÇEVCI Riza (1947-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Sankoc të Drenasit. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe në Komoran, Shkollën Normale në Mitrovicë, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi në shkollën fillore të fshatrave të Drenicës, kurse më vonë zuri punë në gazetën "Rilindja", si lektor e gazetar. Pas shuarjes së kësaj gazete punoi në të përditshme të ndryshme, si gazetar dhe redaktor i faqeve për fëmijë. Botoi një sërë recensionesh për libra të rinj. Vazhdon të botojë artikuj për çështje aktuale politike në gazeta të ndryshme. Shkruan kryesisht për fëmijë: poezi, pjesë teatrale, romane etj. Kohët e fundit botoi një varg poemash, në të cilat ngrihet lart lufta heroike e

shqiptarëve për liri dhe pavarësi. Është laureat i çmimit të revistës “Pionieri” për librin e vitit dhe i çmimit “Sofra poetike”. Veprat e botuara: “Gugumani” (1981), “Ylberja” (1984), “Kosova nga Bujanoci në Çamëri” (1993), “Bubulina” (1995), “Të fala nga Tirana” (1999), “Tringa e Prekazit” (2000), “Vallja e pavarësisë” (2008) etj. (Arif Demolli)

GRALISHTA E KORISHËS. Vendbanim parahistorik dhe fortifikim i antikitetit të vonë. Njihet me toponimet “Gralishtë” dhe “Kodra e Kalasë”. Gjendet në majat e dy kodrave (728 dhe 760 m) në juglindje të Korishës (Prizren). Fortifikimi parahistorik i vendosur në kodrën me kuotë 760 m, përbëhet nga një ledh fortifikues prej dheu dhe gurësh. Gjetje qeramike të periudhës së bronzit ka edhe në shpatin lindor të kodrës me lartësi 728 m. Fortifikimi i antikitetit të vonë zë majën e kodrës (728 m), me sipërfaqe prej rreth 0.3 ha, por vendbanimi shtrihet dhe në shpatet veriore dhe perëndimore. Pranë hyrjes së vetme të fortifikimit, në pjesën verilindore, gjendet kisha paleokristiane (20,7 x 9,20 m). Kisha ka orientimin lindje-perëndim, muraturë guri (0.70 m) dhe shtrojë prej balte të ngjeshur. Janë ruajtur apside, naosi, nartekxi, pesë porta, gjurmët e kangjellës dhe të sintronit. Gërmimet u zhvilluan në vitet 2002, 2004 dhe 2007. (Gëzim Hoxha)

GRAMAÇELI. Fshat në komunën e Deçanit, rreth 12 km në juglindje të qytetit. Është vendbanim i tipit fushor dhe shtrihet në lartësi mbidetare 490 m. Ka 1,097 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 4.5 km², nga e cila rreth 80% të sipërfaqeve janë të mbuluar me tokë bujqësore, ndërsa pjesa tjetër me pyje dhe kullosa. Nga objektet e standardit shoqëror, ka shkollën fillore dhe stacionin shëndetësor. (Idriz Shala)

GRAMATIKAT E SHQIPES NË KOSOVË. Gramatikat e para të shqipes të botuara në Kosovë ishin tekste mësimore për shkollat fillore, që u botuan pak vjet pas Luftës së Dytë Botërore. Gramatika e parë shqipe e botuar në Kosovë është “Gramatika e gjuhës shqipe” nga autorët Hasan Vokshi dhe Tajar Hatipi (1952), si tekst mësimor për klasën IV të shkollës fillore. Tri vjet më vonë u botua “Sintaksa e gjuhës shqipe” (1955) e Salih Kolgecit, po ashtu si një tekst mësimor për shkollat fillore. Dy vjet më vonë, më 1957, Hasan Vokshi

botoi “Gramatika e gjuhës shqipe” për klasën VII dhe VIII të shkollës fillore. Këto janë përvojat e para të deriatëhershme në hartimin e gramatikave në Kosovë. Këto gramatika ishin hartuar në frymën e gramatikave mësimore të botuara në Shqipëri qysh para Luftës së Dytë Botërore nga Xhuvani të viteve ’20-’40 (1919, 1922, 1933) dhe I. D. Sheperi (1927) dhe gjatë luftës, J. Rrota (1942) e O. Myderrizi (1944). Më 1971 u ribotua gramatika e Stefan Priftit “Sintaksa e gjuhës shqipe; Gramatika e gjuhës shqipe” (Fonetika-Morfologjia) e Shaban Demirajt dhe “Sintaksa e gjuhës shqipe” si tekst universitar dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” (Sintaksa) si doracak për shkollat e mesme në Kosovë nga Mahir Domi. Këto gramatika, të cilat në koncepte, metodë dhe përmbajtje ishin pothuajse të njëjta, avancuan studimet sintaksore në shqipe. Më pas u botuan një sërë gramatikash kryesisht për nivele të arsimit fillor dhe të mesëm, të cilat janë paraqitur në mënyrë kronologjike më poshtë: “Gjuha jonë”, gramatikë për klasën e tretë dhe të katërt të shkollës fillore, botuar më 1975 nga autorët: Musa Nushi, Riza Brada dhe Zijadin Munishi dhe “Gjuha jonë” nga Zijadin Munishi. Më 1976 u ribotua “Gramatika e gjuhës shqipe” (për klasën I dhe II të shkollave të mesme) nga Shaban Demiraj e Nikoleta Cikuli dhe u botua “Gjuha Jonë” nga Vehida Topçiu dhe Menduh Begolli. Më 1978 u botua “Gramatika e gjuhës shqipe” (Fonetikë-Morfologji) për klasën VI dhe më 1979 “Gramatika e gjuhës shqipe” (Sintaksë) për klasën VII nga Ahmet Kelmendi dhe më 1980 e 1981 “Gramatika” (Sintaksë) dhe “Gramatika” (Morfologji) për nxënësit e shkollave të mesme. Më 1979 u botua ajo që është e njohur si gramatika e parë në gjuhën shqipe nga Sami Frashëri “Shkronjëto e Gjuhësë Shqip” që ishte botuar për herë të parë në Bukuresht më 1886 (ribotim i Prishtinës, 1979, me tejshkrim e redaktim të Rexhep Ismajlit). Më 1982 “Gjuha jonë” për klasën VIII të shkollës fillore nga Isa Bajçinca. Më 1983 “Gjuha jonë” për klasën e tretë të shkollës fillore nga Musa Nushi, Riza Brada dhe Mehmet Surdulli. Më 1989 u ribotua si tekst universitar “Gramatika e gjuhës letrare shqipe” nga grup autorësh: Dhrimo, Angoni, Lafe, Hysa, Agalliu, Demiraj. Më 1989 “Gjuha jonë” për klasën VI të shkollës fillore nga Latif Mulaku dhe Ahmet Kelmendi. Më 1991 si tekst universitar u botua “Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”

nga grup autorësh dhe “Gramatika e gjuhës shqipe” (për mësimdhënësit e gjuhës shqipe) nga Bahri Beci. Më 1998 “Gjuhë e sotme shqipe I (Fonetikë-Morfologji)” nga Musa Nushi, për Shkollën e Lartë Pedagogjike. Më 1999 “Gjuha shqipe 5”, “Gjuha shqipe 6” dhe “Gjuha shqipe 7” nga grup autorësh: Bahri Beci, Loredan Bubani dhe Zamira Gurabardhi dhe “Gjuha shqipe” për klasën IX nga Bahri Beci dhe Xhevat Sylja. Më 2010 u botua “Gramatika e gjuhës shqipe” nga Ali Jashari dhe Bahtjar Kryeziu. Më pas në tregun e Kosovës, kur çështja e botimit të librit sidomos për arsimin fillor u liberalizua, konkurruan një numër gramatikash si tekste mësimore për arsimin fillor, si: “Gjuha shqipe 5” nga Rita Petro, Idriz Metani, Adelina Çerpja dhe Shpresa Hoxha, “Gjuha shqipe 8” nga Rita Petro, Adelina Çerpja dhe Idriz Metani dhe “Gjuha shqipe 9” nga Adelina Çerpja dhe Idriz Metani. Më 2013 u botua si tekst universitar “Morfologji e zbatuar”, dedikuar studentëve të gjuhëve të huaja nga Ali Jashari dhe Flutura Çitaku. Më 2014 Bahri Beci botoi “Gjuha shqipe” për shkollat fillore për klasët VI-IX. Më 2015 u botua për herë të parë në Kosovë një gramatikë tekste “Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe” nga autorët Bardh Rugova dhe Linditë Sejdiu-Rugova që shqyrton probleme përtej fjalisë. (Bahri Koskoviku)

GRANTOLLI Arlind (1978-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Vijoi dy kurse të plota në Universitetin Amerikan në Blagoevgrad të Bullgarisë, “Basic Principles Media” dhe “Basic Publishing Media” (1999-2000). Në vitin 2001 u bë pjesë e redaksisë së sportit të “Kohavisionit” (KTV). Krahas kronikave nga terreni, ku u angazhua në realizimin dhe moderimin e disa emisioneve sportive, si “Derbi”, “Metropol”, “Arena Sportive”, “Infosport”, “E shtuna sportive” etj. Krahas emisioneve, ishte i përfshirë edhe në komentimin e ngjarjeve të mëdha sportive të transmetuara nga KTV-ja. Ishte redaktor i redaksisë së sportit në KTV, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve Sportivë të Kosovës (2015) dhe më pas gazetar dhe redaktor i sportit në Radiotelevizionin e Kosovës. (Ejup Llumnica)

GRAPCI Abdurrahman (1938-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin,



ABDURRAHMAN
GRAPCI

ndërsa studimet për inxhinieri elektrike i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1963). Po aty i përfundoi edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti temën e disertacionit (1977). Pas studimeve u punësua në kombinatin “Trepça”, u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Prishtinë (1968), ndërsa një vit më vonë ligjërues në Fakultetin Teknik (1969), më pas docent, profesor inordinar dhe më 1984 profesor ordinar për lëndën teknika e rregullimit. Është autor i tekstit universitar “Rregullimi automatik i sistemeve lineare” (1985). Në vitin 1977 u zgjodh drejtor i Entit për Elektroteknikë, Makineri dhe Ndërtimtari, i cili më vonë u shndërrua në Institutin Tekniko-Teknologjik në kuadër të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës. (Enver Hamiti)

GRASHTICA PARAHISTORIKE. Varrezë e sheshtë me urna të kulturës dardane, e cila datohet në kapërcyell të epokës së bronzit në të hekurit (shek. XIII-IX p.e.r.). Ndodhet në “Arat e Rrafshit” të fshatit Grashiticë, rreth 9 km në veriperëndim të Prishtinës. Gjatë hulumtimeve (1991-2013) janë zbuluar 62 varre, 58 me djegie dhe 4 me trupvënie. Tipike për varret me djegie është vendosja e eshtrave të djegura në urna dykonike, të cilat mbylleshin thuasë hermetikisht me nga një pjatë të thellë konike. Urnat janë vendosur në gropa dheu, në grupe me nga 2-9 urna. Ndeshen edhe urna fëmijësh e të rriturish, që janë të veçuar nga grupet e varreve. Ka edhe varre të rrethuara me rrasa gurësh shtufi të papërpunuar. Varret me trupvënie kanë trupa të vendosur në njërin krah, në pozicion të gërmuqët, këmbë të përthyerë në gjunjë, me orientim verilindje-jugperëndim. Inventari përbehet nga urna qeramike dykonike, pjata të thella konike, tasa, filxhanë, fragmente të enëve me motive gjeometrike dhe stoli të bronzit, ashtit dhe qelibarit. (Haxhi Mehmetaj)

GREGORA Nikifor (1295-1359/60). Historian dhe dinjitar bizantin nga Heraklea Pontika (në brigjet lindore të Detit të Zi). Që në moshë të re shkoi në Konstandinopojë për të studiuar. Atje u shqua në lëmin e astronomisë,

historisë dhe të dijeve të tjera dhe u shpërblye nga perandori Androniku II (1254-1258) me postin e hartofilaksit (arkivist perandorak). Në Kuvendin ekumenik të vitit 1351 ra në konflikt të hapur me perandorin Johan VI Kantakuzen (1347-1354). Si rrjedhojë, nga viti 1351 deri në vdekjen e këtij perandori, u detyrua të bëhej murg, sepse iu ndalua dalja jashtë manastirit. Nikifori shkroi disa biografi, polemika filozofike, letrare etj. Propozoi reformimin e Kalendarit Julian, por u kundërshtua nga oborri perandorak. Reformën e këtij kalendari e bëri papa Gregori XIII (1582), pothuaj sipas konceptit të Nikiforit. Vepra më e njohur e Nikiforit është "Historia romane", në 36 vëllime. Në të ka informacione edhe për popujt e Ballkanit, përfshirë edhe qytetet Krujë, Lipjan dhe Prizren, si qendra të njohura të krishterimit. Me etnonimet arbër dhe ilir Nikifori nënkupton popullatën arbërore, që tashmë në fillim të shekullit të katërmëdhjetë kishte filluar të depërtonte në Thesali. Në të flitet edhe për vrasjen e Stefan Uroshit III, siç thotë ai "vrasja u bë me ngulfatje në burg" nga djali i tij, Stefan Dushani. Nikifori ishte i ndikuar nga Platoni, të cilit shpesh i referohet në shkrimet e tij filozofike. (Ramiz Abdyli)

GREJ Eduard (Sir Edward Grey) (1862-1933).

Sekretari i Jashtëm i Britanisë së Madhe. Lindi në Londër. U arsimua në Oksford, në shkencat juridike. Në vitin 1885 hyri në Dhomën e Ulët të Parlamentit. Në vitet 1892-1895 punoi në sekretariat shteti për punët e Jashtme. Nga viti 1905 deri në vitin 1916 shërbeu si sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe. Gjatë qëndrimit në këtë post, mbrojti aleancën e Britanisë



EDUARD GREJ

së Madhe me Francën kundër Gjermanisë. Në vitin 1907 nënshkroi një marrëveshje me Rusinë, e cila vuri bazën e krijimit të Antantës. Në bashkëpunim me fuqitë kryesore europiane, Grej ndërhyri në krizën ballkanike, duke thirrur Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në vitin 1913. Mori pjesë në hartimin e Paktit të Fshehtë të Londrës (1915), që parashikonte copëtimin e Shqipërisë. Në vitet 1919-1920 kreu detyrën e ambasadorit të Britanisë në SHBA. Në vitet 1923-1924 udhëhoqi opozitën

liberale në Dhomën e Lordëve. Njihet për deklaratën e tij të bërë më 1913 në Dhomën e Komunave lidhur me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve për Shqipërinë, kur thoshte se vendimi për Shqipërinë do të japë shkas për shumë kritika, por qëllimi ka qenë ruajtja e marrëveshjes midis Fuqive të Mëdha, "në dobi të paqes në Europë". Një vit më vonë, mosmarrëveshjet midis Fuqive të Mëdha çuan në Luftën e Parë Botërore. (Islam Lauka)

GREQIZMAT. Fjalë a shprehje të huazuara nga greqishtja. Në gjuhën shqipe është argumentuar prania e një numri jo të vogël fjalësh të greqishtes, të cilat vijnë si rrjedhojë e marrëdhënieve shumëshekullore ndërmjet këtyre dy vendeve fqinje. Këto fjalë u takojnë periudhave të ndryshme të greqishtes: greqishtes së vjetër (deri në shek. VI e.r.), greqishtes së mesme (shek. VI-XII) ose greqishtes së re (pas shek. XII). Sh. Demiraj i konsideron elementet e greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe si fjalë të trashëguara (por prej burimi të huaj) nga paraardhësja e shqipes, ilirishtja, dhe jo huazime të drejtpërdrejta të vetë shqipes. Huazimet nga greqishtja e vjetër mendohet të jenë shumë të hershme, por, sipas historianëve të gjuhës, shekulli III para e.r. cilësohet si limit deri kur mund të shpjegohen këto huazime me mjetet e gjertanishme. Numri i huazimeve të kësaj periudhe është i vogël. Në gjuhën shqipe ndeshen mbi 30 fjalë nga greqishtja e vjetër, si: *mokën /mokër, drapën/ drapër, presh, qersh* etj. Përveç huazimeve nga greqishtja e vjetër, gjuha shqipe ka huazuar një numër të konsiderueshëm fjalësh nga greqishtja e mesme dhe nga greqishtja e re. Këto janë pa krahasim më të shumta se elementet nga greqishtja e vjetër. Dhe kjo është e shpjegueshme, po të mbahet parasysh se ndikimi i greqishtes mbi shqipen ka ardhur duke u shtuar pas vendosjes së greqishtes si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine, aty nga shekulli VII e.r. Këto huazime kanë pësuar më pak ndryshime se elementet nga greqishtja e vjetër dhe kanë depërtuar më fort në të folmet jugore të shqipes. Por, huazime nga greqishtja e mesme kanë depërtuar edhe në të folmet veriore, si fjalët e sferës fetare: *kllogjën, manastir*, si dhe fjalë sferash të tjera si: *benevrekë, dafne* (=dafinë), *skile, trëndafil* etj. Huazimet greke në pjesën më të madhe kanë depërtuar në gjuhën shqipe nëpërmjet

gjuhës së folur, por në kohë më të reja kanë hyrë edhe nëpërmjet gjuhës së shkruar. Këtu është fjala kryesisht për terma që janë ndërtuar nga brumi i greqishtes dhe që në gjuhën shqipe kanë hyrë më fort nëpërmjet gjuhëve romane, si: *aristokraci, gjeografi, morfologji, sintaksë, demokraci* etj. (Kadire Binaj)

GREVA E MINATORËVE TË TREPÇËS (20-28 shkurt 1989). Grevë e minatorëve në xehërorën e Stantërgut, në kuadër të Trepçës, që u mbajt kundër ndryshimeve kushtetuese, me të




GREVA E MINATORËVE TË TREPÇËS MË 1989

cilat Serbia synonte suprimimin e autonomisë së Kosovës. Greva ishte edhe shprehje e pakënaqësisë me situatën e përgjithshme politike në vend, e cila karakterizohej nga agresiviteti i politikës antishqiptare të Serbisë dhe nga paaftësia e udhëheqjes së Kosovës për t'iu kundërvënë asaj politike. Tubimi i parë i minatorëve u mbajt në minierën e Stantërgut më 4 shkurt 1989, ku morën pjesë rreth 2,500 punëtorë. Minatorët ishin kundër amendamenteve të reja serbe, ngase nuk ishin në harmoni me Kushtetutën e vitit 1974. Më 20 shkurt të vitit 1989 shpërthyen demonstratat e shqiptarëve kundër heqjes së autonomisë së KSA të Kosovës nga RS e Serbisë. Në krye të demonstratave dolën minatorët e kompleksit industrial të Trepçës në Mitrovicë. Ndërkohë, rreth 1,500 punëtorë nisen grevën e urisë në galeritë e thella të Minierës së Stantërgut. Minatorët iu përmbajtën parimit “Një për të gjithë, të gjithë për një”. Kërkesa kryesore ishte dorëheqja e tre udhëheqësve partiakë të Kosovës (Ali Shukriut, Rahman Morinës dhe Hysamedin Azemit). Këshilli grevist përpiloi edhe dhjetë kërkesa të tjera, ku përfshihej mosndryshimi i Kushtetutës së

vitit 1974, ndërprerja e politikës shoviniste dhe hegjemoniste serbe ndaj shqiptarëve, si dhe kërkesa që çështja e Kosovës të diskutohej në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Greva zgjati deri më 28 shkurt 1989. Ajo përfundoi me hospitalizimin e 180 minatorëve dhe me manipulimin e dorëheqjes së tre funksionarëve politikë të Kosovës. Pas ndërprerjes së grevës, në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme dhe ora policore. Greva pat jehonë të madhe në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm. Por, me gjithë demonstratat dhe protestat e shumta të popullit të Kosovës pushteti serb më 23 mars 1989, në gjendjen e shtetrrethimit aprovoi amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974. Pas kësaj filloi represioni i pushtetit serb në Kosovë, situatë që u përshkallëzua gjatë viteve në vijim. (Naim Musliu)

GREZDA Kadrush (1950-). Arkitekt. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Sarajevës (1975). Punën e filloi në kombinatin industrial “Dukagjini” dhe më pas ishte shef i sekretariatit për urbanizëm në Gjakovë (1984). Në periudhën 1979-1986 u angazhua si asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës në lëndët e projektimit. Në vitin 1988 themeloi atelienë e parë private projektuese në Kosovë “Arkos”, ku janë hartuar një sërë projektesh për Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri. Ishte menaxher i projektimit në kompaninë amerikane “Contraction Management Aleance” (CMA) në Prishtinë. Është fitues i çmimit të parë në konkursin për hartimin e planit urbanistik të qendrës së qytetit të Gjakovës. Si projektues kryesor, në kuadër të kompanisë CMA, ka realizuar projektin për rehabilitimin e kullës të Pallatit të Shtypit, të planeve rregulluese urbanistike të lagjeve “Kalabria” dhe “Lakrishte” etj. Është fitues i shumë shpërblimeve dhe mirënjohjeve. (Dervish Qerreti).

GREZDA Qamil (1917-1992). Piktur. Lindi në Gjakovë. Kur ishte shtatë vjeç familja e tij u vendos në Krumë. Kreu filloren dhe gjimnazin në Shkodër me mësues piktorin Simon Rrota. Më 1936 u regjistrua në Shkollën e Vizatimit në Tiranë, me pedagogë A. Buzën, O. Paskalin etj. Ekspozoi për herë të parë në Panairin Ndërkombëtar të Selanikut më 1937, ku mori



QAMIL GREZDA

diplomën dhe medaljen e artë. Më 1939 vazhdoi studimet për pikturë, në Akademinë e Arteve në Romë dhe Firence. Nga ajo kohë realizoi tablotë: “Grua dardhare”, “Breg lumi”, “Portreti i babait” etj. Pas studimeve ishte piktor në Teatrin Kom-

bëtar në Tiranë dhe në Filarmoninë e Shqipërisë, pastaj drejtor i Muzeut të Luftës Nacionalçlirimtare, pedagog në shkollat “Jordan Misja” dhe “17 Nëntori”. Cilësohet peizazhist me individualitet të theksuar krijues. Realizoi tablo me motive nga Lura, Thethi, Valbona, zonat rreth Tiranës etj. Piktura e tij shquhet për mjeshtërinë e ngjyrave, studimin e detajeve dhe fakturën e gjurmës së brushës. Janë të njohura tablotë që paraqesin ngjarje historike (“Gryka e Kaçanikut”, “Kalaja e Krujës”, “Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit” etj.) dhe portrete të figurave patriotike (B. Curri, I. Boletini, H. Prishtina etj.). Veprat e tij gjenden në shumë galeri, muze e koleksione private. (Blerim Luzha)

GRIPI. Është sëmundje e rëndë ngjitëse, që ka tendencë të marrë formë epidemike dhe pandemike. Shkaktohet nga viruset e influencës A, B dhe C. Periudha e inkubacionit sillet nga disa orë deri në dy ditë. Sëmundja fillon furishëm, me ethe, temperaturë, dhembje të nyjave, muskujve, pagjumësi, hiperemi të sklerave dhe dhembje të kokërdhokëve të syve, kollë të thatë dhe me dhembje prapa sternumit. Gripi karakterizohet me shkallë të lartë të përhapjes. Të gjitha grupet e popullatës janë të ndjeshme ndaj gripit, por personat me sëmundje kronike apo sistem imunitar të dobësuar kanë pasqyrë klinike më të rëndë. Pas kalimit të sëmundjes, imuniteti është tip specifik dhe i shkurtër. Janë këto pandemitë më të mëdha: Pandemia e “gripit spanjoll”, tipi H1N1 në vitet 1918-1919 që vrau 20-50 milionë njerëz. “Gripi aziatik” H2N2 në vitet 1957-1958 përfshiu 80 milionë të sëmurë dhe la 1 milion të vdekur. Pandemia zgjati 6 muaj. Në vitin 1963, një pandemi tjetër la 34,000 të vdekur. Gripi i Hong Kongut (H3N2) në vitin 1968 la 1 milion të vdekur (vetëm në SHBA kishte 30 milionë të sëmurë, 20,000 të vdekur). Në vitin 1975 paraqitet një lloj i ri i gripit, “Gripi i derrave” (A S1N1). Nga pandemia e vitit 2009

(A-H1N1) u sëmurën 343,298 persona, nga të cilët vdiqën 4,108 veta. Çdo vit nga gripi sezonal në Europë vdesin deri në 50,000 njerëz, kryesisht të moshuar dhe persona me sëmundje kronike. Masë më efektive e parandalimit është vaksinimi. Edhe në Kosovë vaksinimit kundër gripit i nënshtrohen grupet me rrezik të lartë: shtatzënat, personat me sëmundje kronike kardiovaskulare dhe respiratore, personat me sistem imunitar të dobësuar. (Isme Humolli)

GROSHI-HUSAJ Shaban (1919-1998). Lahutar, rapsod popullor. Lindi në katundin Shkrel të Rugovës. Kishte në repertor mbi 10,000 vargje të eposit të kreshnikëve, por repertori i tij i plotë nuk është incizuar në tërësi. Mbledhësi kryesor i këngëve të tij ishte Nimon Alimusaj, kurse kishte edhe mbledhës të tjerë nga Prishtina e Tirana, ndër ta edhe Qemal Haxhihasani. Këngët e tij janë botuar në vëllimet e Institutit Albanologjik të Prishtinës (1974, 1983) dhe në vëllimin e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë (1983). Ishte anëtar i një familjeje me traditë të këndimit me lahutë: ishte i biri i Grosho Ibrës, dëshmor dhe lahutar i njohur. Këngët e tij shquhet për rrëfimin e gjatë epik, duke e ruajtur legjendaritetin dhe poetikën e kohës, figuracionin etj. Këngët e tij u analizuan në punime studimore nga shumë studiues të folklorit nga Kosova dhe Shqipëria. (Zymer U. Neziri)


GRUBI Blerim (1965-). Violist. Lindi në Shkup, ku kreu mësimet fillore dhe Shkollën e Mesme të Muzikës, drejtimi për violë. Kreu studimet për violë në Akademinë e Arteve në Shkup, ndërsa masterkursin në Akademinë “Chigiana” të Sienës. Punoi në Filarmoninë e Maqedonisë, zhvilloi aktivitet të ngjeshur koncertal si solist dhe në disa formacione kamerale. Në vitet ‘80 udhëheqës i violave në orkestrën kamerale të “Rinisë Muzikore” në Shkup. Në Kosovë i kontribuoi riaktivizimit të jetës muzikore: themelues i Ansambllit “Vivendi”, anëtar i trios harkore të Kosovës, themelues i Shoqatës së Artistëve të Muzikës e Baletit Shqiptar në Maqedoni, i Festivalit “Multi-kulti” në Shkup, ndër iniciatorët e



BLERIM GRUBI

Shkollës së Mesme të Muzikës në Tetovë. U prezentua solist me Filarmoninë e Maqedonisë, të Kosovës, Orkestrës së Teatrit, Operës dhe Baletit në Tiranë, orkestrës kamerale ballkanike. Bashkëpunoi me ansamble të formatit ndërkombëtar. Përpilues i garave muzikore në Prishtinë (2003-2006), i konkursit “Musicians of New Millenium” (Shkup, 2004), anëtar i këshillit artistik të Festivalit “Vera e Ohrit” (2005-2006), udhëheqës violash në Filarmoninë e Maqedonisë (1992-2004) dhe në atë të Kosovës (nga viti 2000). Incizoi disqe me vepra për violë. Është profesor i katedrës së violës nga viti 1994 në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Sami Piraj)

GRUDA Zejnullah (1936-). Jurist, profesor universitar, diplomat. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës,



ZEJNULLAH GRUDA

magjistroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, ku edhe u doktorua në Fakultetin e Shkencave Politike. Më 1962 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik-Ekonomik, më pas ligjërues, profesor inordinar dhe ordinar i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP) për lëndën e drejta ndërkombëtare publike. Ligjëroi edhe në Fakultetin e Shkencave Politike të UP-së dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Ishte ambasador i RSF të Jugosllavisë në Republikën e Panamasë (1975-1978), pastaj anëtar i Këshillit Ekzekutiv të KSA të Kosovës dhe sekretar Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme. Është laureat i çmimeve dhe dekoratave të ndryshme. Ka botuar punime shkencore, trajtesa dhe shqyrtime nga fusha e së drejtës ndërkombëtare, si dhe është autor dhe bashkautor i teksteve universitare: “E drejta ndërkombëtare publike” I, II (1984, 1994), “Mbrojta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut” (2010), “Manual diplomatik” (2009), “Demarkacioni Kosovë-Mali i Zi” (2016) etj. (Osman Ismaili).

GRUPI I KONTAKTIT PËR BALLKANIN. U themelua më 26 prill 1994, me qëllim të zgjidhjes së krizës së ish-Jugosllavisë. Ky mekanizëm i diplomacisë *ad hoc* mori përsipër përgjegjësinë

për zgjidhjen e krizës në Bosnjë e Hercegovinë dhe më pas edhe në Kosovë. Grupi i Kontaktit përbëhej nga SHBA-ja, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Rusia. Grupi filloi të trajtonte çështjen e Kosovës më 24 shtator të vitit 1997, në vigjilje të takimit të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. Si hap i parë, Grupi i Kontaktit shihte implementimin e “Marrëveshjes së arsimit”, të nënshkruar ndërmjet Rugovës dhe Millosheviqit në shtator të vitit 1996, si dhe vazhdimin e masave shtesë për ndërtimin e mirëbesimit në Kosovë. Një rol të veçantë Grupi i Kontaktit luajti edhe gjatë viteve të luftës 1998-1999. Veçanërisht i rëndësishëm qe roli i tij gjatë Konferencës së Rambujesë (1999), kur vendet anëtare përcaktuan kornizat e negociatave paqësore të njohur si “Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë”. Roli i Grupit të Kontaktit ishte përcaktues edhe gjatë procesit të adresimit të statusit përfundimtar të Kosovës në vitet 2006-2007. Në nëntor të vitit 2005 Grupi i Kontaktit i bëri të njohura 10 parimet bazë për zgjidhjen e statusit të Kosovës, mbi të cilat u orientua tërë procesi negociues i Martti Ahtisarit për statusin final të Kosovës. (Sylë Ukshini)

GRURI. (*Triticum aestivum* L.) Bimë njëvjeçare e familjes *Poaceae*. Kultivohet për kokrrën që ka vlera të larta ushqyese: amidon 66.4%, proteinë 13%, celulozë 3%, yndyrë 1.5%, materie minerale 1.7% dhe ujë 14.4%. Me bluarjen e kokrrës së grurit përfitohet mielli i cilësisë së lartë, nga i cili përgatitet buka dhe një sërë prodhimesh të tjera. Gruri në Kosovë mbillet gjatë muajit tetor dhe korret në muajin korrik. Sipërfaqet e mbjella me grurë kanë qenë shumë më të mëdha deri në 108,000 ha (1976), në krahë me ato të mëvonshme (70,000 ha në vitin 2014). Rendimenti mesatar për një hektar sillej nga 800 kg (1955) deri 4,100 kg (2009). Më herët për kultivim janë përdorur kultivarët dhe populacionet vendore, por edhe Golia dhe Bankut-1205. Më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, filloi përdorimi i kultivarëve me potencial të madh prodhues dhe me qëndrueshmëri ndaj kërpudhave patogjene të ndryshkut, të blözës (*Uredinales*, *Ustilaginales*) dhe të hirit (*Erysiphales*): San Pastore, Libelulla, Autonomia (Itali), Bezostaja-1 (BRSS), Zlatna Dolina, Zhitarka, Partizanka, NSR-2 dhe KG-56 (1945-1970); Balkan, Jugosllavia, Skoplanka (1970-

2000) dhe Europa-90, Pobeda, Renesansa, Soissons dhe Isaingren (Francë), Lenta, Luna, Gabi, Prima-Kroaci (2001-2015). Në Fakultetin e Bujqësisë punohet në krijimin e kultivarëve të rinj në grurë për kushtet agroklimatike të Kosovës. (Shukri Fetahu)

GRYKA E CARRALEVËS. Grykë lumore në malet e Carralevës e formuar nga lumi me të njëjtin emër. Ka gjatësi rreth 8 km, gjerësi 25-40 m, kurse thellësia e saj është 150-200 m. Është e formuar në shkëmbinj flihorë të moshës së kretakut. Nëpër grykën e Carralevës rrjedh lumi me të njëjtin emër, ujërat e të cilit derdhen në lumin e Shtimes, pastaj në Sitnicë. Gryka e Carralevës është kalim natyror shumë i rëndësishëm, pasi ka mundësuar ndërtimin e rrugës automobilistike Prishtinë-Prizren, duke lidhur Rrafshin e Kosovës me Rrafshin e Dukagjinit. (Valbon Bytyçi)

GRYKA E GRADISHËS. Luginë lumore epigenike tek Ura e Fshejtë, në afërsi të fshatit Xërxë. Luginën (kanionin) e ka krijuar Drini i Bardhë, duke ndërprerë shkëmbinjtë gëlqerorë shtresëtrashë, ngjyrë të bardhë dhe të kuqërremtë të Kodrës së Gradishës të fshatit Gexhë. Kanioni është i gjatë rreth 700 m, i thellë afër 45 m, i gjerë 6-8 m, ndërsa thellësia e ujit 0.5-7.0 m. Në shpatet e tij gati vertikale, të përbërë nga gëlqerorët ngjyrë të bardhë, paraqiten zgavra, shpella dhe burime të vogla karstike. Gryka e Gradishës (Kanioni i Drinit të Bardhë) paraqet monument natyror morfologjik të rëndësishëm, ndërsa dalja jugore e saj është vend rekreacioni, i cili shfrytëzohet nga qytetarët e Gjakovës, Rahovecit dhe fshatrave të afërta. (Vahdet Pruthi)

GRYKA E KAÇANIKUT. Grykë lumore në pjesën jugore të Kosovës. Është formuar në mes të maleve të Sharrit (2,702 m) në perëndim dhe maleve të Karadakut (1,651 m) në lindje. Gjatësia arrin 17.5 km. Nëpër të rrjedh lumi Lepenc. Paraqet lidhjen më të përshtatshme natyrore ndërmjet Rrafshit të Kosovës, në veri, dhe fushëgropës së Shkupit, në jug. Në pjesën më të madhe është e prerë në shkëmbinjtë kristalorë, ndërsa në juglindje në fliшин e kretakut. Formimi i grykës është i kushtëzuar nga ekzistimi i kontaktit litologjiko-tektonik përgjatë saj. Në të kaluarën gjeologjike liqeni pliocen i Shkupit lidhej me liqenin e Kosovës. Prejshtratit të lumit Lepenc deri në 150 m lartësi



PAMJE E GRYKËS SË KAÇANIKUT

ka shpate të pjerrëta, ndërsa mbi këtë lartësi ajo zgjerohet dhe është e mbuluar me livadhe, kullosa dhe vegjetacion pyjor. Nëpër këtë grykë lumore kalon magjistralja automobilistike dhe hekurudha Prishtinë-Shkup. (Arsim Ejupi)

GRYKA E KONÇULIT. Grykë lumore në lindje të Kosovës. Lugina grykore e Konçulit paraqet lidhjen më të përshtatshme natyrore ndërmjet Anamoravës dhe Rrafshit të Kosovës, në perëndim, dhe Luginës së Preshevës e Serbisë Jugore, në lindje. Nëpër të rrjedh lumi Morava e Binçës. Gryka është e gjatë 14 km dhe e thellë deri 200 m. Është prerë në shkëmbinjtë kristalorë paleozoik, që ndërtojnë malet në pjesën lindore të Kosovës. Në territorin e Kosovës është e drejtë, ndërsa nga grykëderdhja e përroit Babanjak e deri në dalje të saj në fushën e Bujanocit, te fshati Lluçan, është meandrike. Nëpër grykën e Konçulit kalon magjistralja rajonale Gjilan-Bujanoc, e cila në qytetin e Bujanocit lidhet me magjistralen ndërkombëtare E-75 dhe Korridorin X. (Arsim Ejupi)

GRYKA ELLAPUSHNIKUT. Grykë në Drenicën Perëndimore. Paraqet lidhjen natyrore ndërmjet dy rajoneve kryesore të Kosovës: Rrafshit të Kosovës dhe të Drenicës në lindje dhe atij të Dukagjinit në perëndim. Paraqet një grykë të butë, të krijuar nga lëvizjet tektonike dhe veprimtaria erozive e rrjedhjes ujore. Është e ngushtë rreth 700 m, e gjatë rreth 1.5

km. Ndan malin Kosmaç në veri nga malet e Berishës në jug. Përmes saj kalon rruga magjistrale Prishtinë-Pejë. (Shpejtim Bulliqi)

GRYKA E RUGOVËS. Grykë lumore në veriperëndim të fushëgropës së Dukagjinit, në pjesën qendrore të Bjeshkëve të Nemuna, e krijuar nga Bistrica e Pejës. Shtrihet ndërmjet



PAMJE E GRYKËS SË RUGOVËS

blloqeve malore të Hajlës dhe Rusolisë në pjesën veriore dhe malit të Bistricës, Koprivnikut, Strelcit në pjesën jugore. Formimi dhe evolucioni morfologjik i kësaj gryke dhe i luginës së Bistricës së Pejës është kushtëzuar nga ekzistimi i sistemeve të thyerjeve tektonike, që shtrihen përgjatë gjithë gjatësisë së luginës, veprimi erozional të akullnajës së Rugovës dhe erozionit lumor të Bistricës së Pejës. Është formuar kryesisht në gëlqerorë dhe dolomitë të moshës triasike e pjesërisht në rreshpet paleozoike. Lugina grykore është e gjatë rreth 12 km, me gjerësi prej 6-10 m dhe thellësi prej 800-1,400 m. Ka trajtën e një kanioni në gjatësi prej 6 km, veçanërisht nga grykëderdhja e përroit të Shtupelit, degë e majtë e Bistricës së Pejës, ku ngrihen në trajtë greminë shpatet gëlqerore pa bimësi. Veçohet gremina e shpatit të djathtë me lartësi relative deri në 1,200 m. Në sektorin e mesëm dhe të sipërm, gryka e Rugovës karakterizohet me asimetri të theksuar strukturore dhe litologjike të shpateve dhe një trajtë gjysmëharkore, me lugëzim nga jugu dhe që lidhet me trajtën monoklinale të bllokut malor

të Bistricës. Me asimetrinë strukturore lidhet edhe prania e degëve nga e majta e kësaj gryke, ndërsa me asimetri litologjike lidhen vlerat shumë herë më të larta të copëtimit të shpatit të majtë në raport me atë të djathtë, veçanërisht me vlerat e larta të dendësisë së copëtimit. Veprimi i erozionit lumor gjatë evolucionit të saj dëshkohet me paraqitjen e fragmenteve të tarracave dhe me pjerrtësinë e madhe të shpateve anësore. Karakterizohet me burime të fuqishme karstike, ku disa prej tyre kanë dukje ujëvarash, ndërsa në pjesët shkëmbore anësore janë disa shpella (Gryka e Madhe). Përgjatë luginës janë ruajtur mirë format glaciale, si: cirqet, lugjet e akullnajave, morenat (afër Patrikanës së Pejës) dhe liqenet akullnajore (Kuqishtë). Me natyrë alpine të relievit, klimë malore, ujëra të bollshëm dhe të pastër të Bistricës së Pejës, është gryka më e bukur në Kosovë, me vlera të larta natyrore e turistike dhe si monument morfologjik. (Shpejtim Bulliqi)

GUCIA Ali Pashë (1817-1885). Komandant ushtarak i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, veprimtar i Lëvizjes Kombëtare. Lindi në Guci. U arsimua në Medresenë e Pejës dhe më pas



ALI PASHË GUCIA

vijoi shkollën ushtarake në Stamboll. Në vitin 1845 u emërua kajmekam i Gucisë, duke pasuar të atin, Hasan Shabanagain. U shqua si udhëheqës në kryengritjet e malësorëve të veriut në vitet '60 të shek. XIX kundër politikës së Tanzimatit dhe kundërshtar i synimeve serbe e malazeze ndaj tokave shqiptare. Pas vendimeve të Kongresit të Berlinit veprroi si udhëheqës, strateg ushtarak e diplomat në mbrojtje të trojeve shqiptare. Në fund të muajit prill të vitit 1878 bëri thirrje për mbajtjen e një kuvendi kombëtar dhe më pas ishte njëri nga organizatorët dhe drejtuesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte një nga udhëheqësit kryesorë të rrymës centriste, e cila kërkonte mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare, si dhe për një ballafaqim të matur me Portën e Lartë dhe për autonomi të Shqipërisë. U emërua komandant i shtabit ushtarak të Lidhjes. Në zbatim të thirrjes së Lidhjes për të kundërshtuar me armë aneksimin e Plavës e të Gucisë nga Mali i Zi dhe të vendimit të Këshillit të Përgjithshëm


të Lidhjes më 3 tetor të vitit 1879, drejtimin e luftës për mbrojtjen e këtyre krahinave e mori përsipër shtabi ushtarake me A. Pashë Gucinë në krye. Shtabi u vendos në Guci, shpalli gjendjen e luftës dhe planëzoi veprimet mbrojtëse. Nën drejtimin e tij luftëtarët shqiptarë mundën ushtrinë malazeze të komanduar nga Mark Milani në betejat në Velikë, Pepaj dhe Nokshiq. Në pikëpamje ushtarake, beteja për Plavën e Gucinë u vlerësua më heroikja dhe më e organizuara e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që e detyroi Knjaz Nikollën të hiqte dorë nga veprimet e mëtejshme luftarake. Pas rënies së Lidhjes së Prizrenit, A. Pashë Gucia qëndroi një kohë i fshehur. Pas amnistisë së përgjithshme të sulltanit dhe me rikthimin e Gucisë nën administratën e Perandorisë Osmane (prill 1880), Porta e Lartë e emëroi mytaserif të sanxhakut të Pejës, me titullin pashë. Nën administrimin e tij, Peja u bë qendër e lëvizjes kombëtare shqiptare. U vra në Pejë më 1885 në rrethana të pasqaruara. (Endrit Musaj)

GUGULI Muhamed (1933-2015). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe kirurg torakal, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin e ulët i kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Zagreb. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup më 1961. Pas diplomimit u punësua në Spitalin e Prizrenit. Specializimin për kirurgji të përgjithshme e kreu në Akademinë Mjekësore Ushtarake në Beograd (1967). Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u emërua asistent i lëndës së kirurgjisë dhe më 1976 kaloi me punë në repartin e kirurgjisë torakale. Mbrojti temën e doktoratës më 1981 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas u zgjodh docent dhe mori titujt e tjerë universitarë. Në vitin 1990 së bashku me shumë kolegë të tjerë u largua nga puna, por u kthye sërish në repartin e kirurgjisë torakale, pas përfundimit të luftës, ku punoi deri më 2002, kur u pensionua. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe botoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. Është autor i monografisë “Ekzaminimi bronkologjik dhe mjekimi kirurgjik i bronhektazive”. (Avdyl Krasniqi)

GUHELLI Lulzim (1971-). Aktor, producent. Lindi në Prizren. Studimet për aktrim i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1995). Që nga viti 1990, fillimisht

në teatrin e Prizrenit dhe më pas në Prishtinë, Gjakovë dhe Pejë luajti një numër rolesh në shfaqjet: “Nata e dymbëdhjetë”, “Vëlla vëlla, kosi me dollarë”, “Togeri nga Inishmori”, “Shfaqja e fundit”, “Komedia”, “Martesa e Barionit”, “Kaligula”, “Vdekja dhe Vasha”, “Këngëtarja tullace”, “Dante 9”, “Moti pa ton”, “Proporcionet hyjnore” etj. Gjithashtu interpretoi role në filmat: “Heroi”, “Rrugët që vrasin”, “Bodrumi” dhe në serialet televizive: “Kafeneja jonë”, “Familja moderne”, “Stinë dashurie”, “Brenda drejtësisë”. U angazhua edhe si regjisor, skenarist dhe producent. Mori disa çmime, si çmimin e publikut për filmin “Përfaqimi” në Festivalin “DokuFest” në Prizren (2014), gjithashtu çmimin e publikut po për këtë film në Festivalin “SwiKos” në Bazel të Zvicrës (2014), ku më herët, më 2011, ishte vlerësuar me çmimin si aktori më i mirë, pastaj aktori më i mirë në Festivalin e Teatrosë të Kosovës në Ferizaj etj. (Emin Emiri)

GUNGA Fahredin (1936-1997). Poet. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje. Mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd. Pas studimeve punoi si mësues në shkollat e mesme të Mitrovicës. Më vonë u punësua si gazetar në “Rilindje”, në Prishtinë. Ishte redaktor dhe kryeredaktor i Shtëpisë Botuese “Rilindja”. Më vonë edhe kryeredaktor dhe drejtor i Televizionit të Prishtinës. Poezitë e para i botoi në fund të viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar. Librin e parë poetik “Pëshpëritjet e mëngjesit” e botoi më 1961, e më vonë: “Mallkimet e fjetuna” (1970), “Kepi i shpresës së mirë” (1973), “Psallmet e ngurta” (1977), “Nokturno për orkidenë” (1981), “Mallkimet e zgjuara” (1985), “Shtrezet e fatësimit” (1990) “Gramatika e gjëllimit” (1996). Shfaqja e poezisë së F. Gungës më 1959 solli sharm rinor, përmes vargut me prirje estradeske dhe për imazhe sureale. Entuziazmin dhe gëzimin, karakteristikë e poezisë pas Luftës së Dytë Botërore, do t’i ketë më të përmbajtura, të frenuara së brendshmi. Reflekset sociale, intime, elegjiake, janë tipare të fazës së parë poetike. Më pas dhe deri në fund, F. Gunga do të shkruajë një vëllim të vetëm të madh përmes



FAHREDIN GUNGA

libra-kapituj. Në fillim vargjet e tij vinin edhe si kronikë poetike për një kohë, për një qytet, për një Kosovë, më pas ajo do të rebelohet si klithje e brendshme, që e vuan atë nga brenda. Në këtë frymë, realizim artistik i fuqishëm vjen vëllimi “Psalmet e gurta”. Kënga e tij do të sfidohet ashpër, prandaj, para se të shpërthejë sheshit, ajo do të jetë e “mbërthyer” ndër nofulla. F. Gunga solli një poetikë fare të veçantë në poezinë shqipe të kohës, solli vargun e shtrirë horizontalisht, me një frymëmarrje të gjerë, me prirje që të thotë, por edhe të rrëfejë njëkohësisht. Ishte laureat i më shumë çmimeve në Kosovë dhe jashtë saj. (Ali Aliu)

GURAKUQI Luigj (1879-1925). Shkrimtar,

publicist, orator e kritik, veprimtar politik. Lindi në Shkodër. Mësimet e para i mori në Kolegjin Saverian në Shkodër, i vazhdoi në Kolegjin italo-arbëresh të Shën Mitrit në Kalabri dhe në Universitetin e Napolit, ku studioi për mjekësi e biologji në vitet 1901-1906. Më pas iu kushtua më shumë veprimit atdhetar e politik, kur mori pjesë në organizimin e kryengritjeve në veri (1907, 1911) e në Kongresin e Manastirit (1908). Veprimin politik me atë kulturor i bashkoi në një, kur mori përsipër të drejtonte Normalen e Elbasanit (1909). Më 1912 mori pjesë në mbledhjen e Bukureshtit, bashkë me Ismail Qemalin, Asdrenin etj., dhe në Kuvendin e Vlorës që firmëtar i Pavarësisë e ministër i Arsimit i Qeverisë së Vlorës, bashkëthemelues i Komisionit Letrar (1916) bashkë me Fishtë, Mjedjen etj., përfaqësues i Shqipërisë në Konferencën e Paqes, deputet i Shkodrës (1921-24), bashkëpunëtor i ngushtë i Nolit dhe ministër i Financave në qeverinë e tij etj. Në disa fletore të kohës, që më 1898, si tek “Albania”, “Hylli i Dritës”, “Ora e Maleve”, “La nazione albanese”, “Kuvendi”, “Përlindja e Shqypnisë”, “Lajmëtari”, “Liri e Shqipërisë”, “Kalendari kombiar”, botoi artikuj publicistikë, poezi e kritika edhe me pseudonimet Lek Gruda e Jakin Shkodra. Ndër artikujt, më të njohur janë “Dy koloni shqiptare në Itali deritash të panjohuna” (Due colonie albanesi in Italia finora sconosciute, 1902), që i kushtoi edhe ndalimin për t’u kthyer në Shqipëri për disa vjet, “Ja halldupë, ja shqipëtarë”



LUIGJ GURAKUQI


(1912), “Dita e flamurit” (1919) dhe “Çashtja e vojtit të gurit” mbajtur si ligjëratë në parlament e botuar si broshurë në 1923. Njohës i mirë i retorikës klasike edhe si oratori, shquhet për fuqinë e shprehjes e bindjes në fjalime, nga cilat kujtohen fjala në hapjen e Normales së Elbasanit (1909), “Mvehtësia e Shqipëniës” (1913) dhe disa fjalime në parlament, mes të cilave shquhen debatet si deputet i opozitës me kundërshtarin e tij politik, Ahmet Zogun. Veprat e botuara nga L.Gurakuqi janë: “Versi” (Napoli, 1905), “Vargënimi n’Gjuhë Shqype” (Napoli, 1906), “Fjalorth Shqyp-Frângjisht e Frângjisht-Shqyp i fjalëve t’reja” (Napoli, 1906). Në Napoli dhe në Athinë botoi abetare dhe libra leximi për shkollat shqipe. Vepra “Vargënimi n’Gjuhë Shqype”, strukturuar në katër kapituj është traktati i parë i teorisë së vargut, por edhe i teorisë e stilistikës së poezisë në shqip, ku praktika klasike e klasiciste e vargnimit lidhet me idenë e të bukurës si kategori ideale. L.Gurakuqi kontribuoi edhe për terminologjinë metrike e poetike në shqip dhe jep shembuj të vargjeve dhe strofave nga autorët shqiptarë dhe nga poezia gojore. Në dy artikuj kritikë prezanton De Radën dhe Skiroin dhe bëhet ndërmjetës i poezisë arbëreshe ndër shqiptarë. Ndërsa poezitë e prozat për fëmijë këndojnë natyrën e stinët dhe marrin trajta këshillash për jetën e shembujsh për t’u ndjekur. Të gjitha poezitë e tjera të shkruara në shqip, gjithsej 16, bashkë me dy proza poetike, L.Gurakuqi i botoi në periudhën 1900-1906. Tema e nostalgjisë, që e ka paraardhës e dialogues F.Shirokën, edhe te L.Gurakuqi bëhet mall e vaj për të kaluarën e për vete, si subjekt e kolektivitet social. “Deka e zanave”, një poezi herë e lëvdar për mjeshtërinë e vargëzimit e herë e kritikuar për ngarkesën erudite, poezi për artin e poezisë, bashkë me poezinë meditative “Qindresa” mben dy poezitë e tij antologjike. L. Gurakuqi u vra në Bari prej kundërshtarëve të tij politikë. (Dhurata Shehri)

GURI Feriz (1970-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Nikaj të Kaçanikut. Mbaroi studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Për t’i ikur shërbimit ushtarak jugosllav, emigroi në Gjermani, ku qëndroi disa vjet. Në radhët e UÇK-së u inkuadrua nga korriku i vitit 1998, kur u nis për në Tropojë të Shqipërisë, për të kryer ushtrime ushtarake. Pas stërvitjeve 6-javore, u kthye në Kosovë dhe

u angazhua në Zonën Operative të Nerodimes. U emërua komandant i togut në fshatin Nikë (janar 1999) dhe më pas komandant kompanie. Ishte pjesëmarrës në betejën e Ivajës dhe në Nikë (prill 1999). U vra nga forcat serbe, duke kaluar kufirin Kosovë-Maqedoni më 22 prill 1999. (Haxhi Ademi)

GURORET. Minierë sipërfaqësore, në të cilën nxirren shkëmbinj (gurë) të thërrmuar (agregate) dhe gurë dekorativë për ndërtimtari, shkëmbinj për prodhim të çimentos, gëlqeres, për përdorim në metalurgji etj. Shkëmbinjtë që më së shpeshti nxirren nga gurorët janë gëlqerorët, dolomitët, dacetet, andezitet (agregate), mermerët, granitet, gabrot, diabazet, gurë dekorativë etj. Në Kosovë deri në vitin 1999 guroret kryesore nga të cilat janë nxjerrë gëlqerorët për agregate kanë qenë guroret e gëlqerorëve të Kroni i Mbretit dhe Çikatovë (Drenicë), Kaçanik, Gllamë (Gjilan), e dacito-andeziteve dhe andezit-bazalteve (Leposaviq), ndërsa gurorë të gurëve dekorativë kanë qenë ajo e Banjës së Pejës (travertinë-oniks) e Deçanit (brekçie mermerore) dhe e Astrazubit (dolomitë dhe mermerë), të gjitha në pronësi shoqërore (shtetërore). Pas vitit 1999 u shtuan shumë kërkesat për gurë të thërrmuar (agregate) nga ana e institucioneve të huaja të vendosura në Kosovë (UNMIK, KFOR), për ndërtimin e rrugëve të reja, bazave të vendosjes etj. dhe u hapën një numër i madh i gurorëve në pronësi private, të cilat me veprimtarinë e tyre e dëmtojnë rëndë peizazhin e natyrës dhe e ndotën së tepërmi ambientin në Kosovë. (Naser Peci)


GURRA E ISTOGUT. Burim i fuqishëm karstik, në lartësi mbidetare 520 m, në rrëzën e malit Mokna, mbi vendbanimin e Istogut, në veriperëndim të Kosovës, që njëherësh paraqet burimin e lumit të Istogut. Gurra e Istogut drenon një akuifer karstik të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë e dolomitorë, me një sipërfaqe të ujëmbledhësit prej 76 km². Me ngjyrosjen e humnerës “Ujërat e Savës” në Malin e Thatë, është konstatuar se edhe gëlqerorët e këtij mali i takojnë ujëmbledhësit të kësaj gurre. Në Gurrën e Istogut uji buron në formë të disa burimeve përgjatë kontaktit të gëlqerorëve masivë të triasikut, në një rën anë dhe formacionit diabaz-strallor e rreshpeve verfeniane, nga ana tjetër. Burimet ujore që dalin përgjatë këtij kontakti, me prurje ujore mesatare vjetore prej 2.4-4.0 m³/sek,



GURRA E ISTOGUT

janë kaptuar (zënë) me punime ujëmarrëse. Bazuar në ujin e kësaj gurre, në Istog u ndërtua hidrocentrali i parë në Kosovë me afër 0.5 MW, me kapacitet të instaluar, ndërsa sot uji shfrytëzohet për furnizim të banorëve të zonës, për ujitje, për kultivimin e troftës kaliforniane dhe për turizëm. (Ruzhdi Pllana)

GURRA E RADAVCIT. Burim i fuqishëm karstik i ujërave nëntokësore. Gjendet afër vendbanimit me të njëjtin emër, në pjesën veriperëndimore të Dukagjinit, në lartësi



GURRA E RADAVCIT

mbidetare 563 m, në rrëzën e Rusolisë e të Zhlebit, afër 9 km në veri të Pejës. Është burimi i Drinit të Bardhë. Rajoni i gjerë i Gurrës së Radavcit ndërtohet nga shkëmbinjtë gëlqerorë të moshës triasike dhe të formacionit diabaz-strallor, me çarje të shkallës së lartë dhe të rrudhosur. Burimi i ujit paraqitet në kontaktin e gëlqerorëve të karstifikuar ujëlëshues, me ngjyrë të bardhë, të triasikut (ujëmbledhës me sipërfaqe afër 120 km²), me shkëmbinjtë joujëlëshues strallorë, me ngjyrë të kuqe e jeshile. Gurra e Radavcit paraqitet në zonën e

kontaktit në formë të një burimi shpërndarës (të shpartalluar), me një zonë të daljes së ujit prej afër 60 m, ndërsa më tutje në rrjedhjen e ujit paraqitet një ujëvarë piktoreske disa metra. Prurja ujore është e ndryshueshme, si gjatë vitit, ashtu edhe ndër vite. Prurjet mujore mesatare kanë ndryshuar prej 1.0 m³/sek deri në mbi 21.0 m³/sek, ndërsa vlerat vjetore mesatare kanë lëvizur nga 3.5 m³/sek deri në 8.0 m³/sek. Për nga përbërja, uji është hidrokarbonat me mineralizim më të vogël se 0.5 g/lit. Gurra e Radavcit paraqet burimin karstik (gurrën) më të fuqishëm në territorin e Kosovës. Një pjesë e ujit nga ky burim është përdorur për furnizim të Pejës, të Banjës së Pejës dhe të Vitomiricës, pastaj për ujitje dhe për hidrocentralin e Radavcit. Sot shfrytëzohet edhe nga kapacitetet e shumta hoteliere, të ndërtuara në afërsi. Paraqet një hidrojeomonument të rëndësishëm, me bukuri të rrallë, që frekuentohet nga vizitorë të shumtë. (Ruzhdi Pllana)

GURRA E VRELLËS. Burim karstik i ujërave nëntokësore afër vendbanimit Vrellë, komuna e Istogut, në rrëzën e Karstit të Kuq të Podgurit të Pejës, në Bjeshkët e Nemuna, në lartësi mbidetare 535 m. Nga ky burim fillon Përroi Voshnica, degë e djathtë e Lumit të Istogut. Burimi i Vrellës drenon ujërat nëntokësore të akuiferit karstik me sipërfaqe afër 6.0 km², të formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë e dolomitorë. Gurra e Vrellës buron në kontakt të shkëmbinjtë gëlqerorë të triasikut të sipërm, me shkëmbinjtë e formacionit diabaz-strallor të jurasikut të mesëm-sipërm (argjilite, stralle, mergele, diabaze). Burimi është i tipit ngjithës (kapërderdhës), me prurje ujore të ndryshueshme, prej 0.12 m³/sek deri në 1.5 m³/sek. Shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijes dhe për ujitje. (Ruzhdi Pllana)

GURRAT E VËRMICËS. Burime karstike në afërsi të vendbanimit Vërmicë, 14 km në jugperëndim të Prizrenit, në anën e majtë të Drinit të Bardhë. Janë burime të ujit, të cilat dalin në kontakt të gëlqerorëve të moshës triasike të Koritnikut (akuifer) dhe melanzhit ofiolitik të moshës jurasike. Prurjet e ujit janë tejet të luhatshme, nga 0.5 deri në 1.6 m³/sek. Burimet janë kaptuar me punime ujëmarrëse dhe uji shfrytëzohet për furnizim të popullsisë me ujë. Ujërat e këtyre burimeve shfrytëzohen

edhe për furnizim të hurdhave, për kultivimin e peshkut dhe për rekreacion. Mbështetur në këto ujëra, në këtë zonë janë ndërtuar edhe disa kapacitete turistike. (Bashkim Kabashi)

GUSIA Ismet (1941-1980). Ekonomist, profesor universitar. Lindi në Tutin, u diplomua në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, kurse titullin e magjistratit të shkencave ekonomike e mori në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Beogradit. Një kohë punoi gazetar në redaksinë e gazetës "Rilindja", më pas u zgjodh asistent dhe profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1971). Në vitin 1973 u zgjodh drejtor i Entit Krahinor të Planifikimit Shoqëror dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës. Në Fakultetin Ekonomik ligjëroi lëndën e zhvillimit të mendimit ekonomik dhe nga kjo fushë ishte edhe autor i një numri punimesh shkencore dhe profesionale, si dhe përkthyes i literaturës shkencore nga fusha e ekonomisë. Temën e disertacionit të doktoratës me titull "Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSA të Kosovës" e paraqiti në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Zagrebit në vitin 1972. Konsiderohej si kuadër perspektiv i Kosovës në fushën e ekonomisë. Vdiq papritmas një ditë para se të mbronte disertacionin. Teza e doktoratës u publikua pas vdekjes, më 1982. (Myrvete Badivuku-Pantina)

GUSHICA. Fshat në komunën e Vitisë, 7 km në jugperëndim të qendrës. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar, me sipërfaqe prej 1,156 ha dhe me lartësi mbidetare 550 m. Rreth 59% e sipërfaqes është me pyje e kulloso, kurse 34% me ara. Gjurmet arkeologjike dëshmojnë për një vendbanim të lashtë antik. Materialet e gjetura dëshmojnë se këtu gjatë shekujve II-III të erës së re ka ekzistuar një vendbanim i përparuar antik me emrin Lubudza. Sipas defterit kadastral të sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566 kishte 19 shtëpi. Pas rënies së Perandorisë Osmane, këtu filloi vendosja sistematike e kolonëve serbë. Sipas regjistrimit të vitin 2011, fshati kishte 801 banorë, ndaj 290 banorëve në vitin 1921. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori. (Përparim Gashi)

GUTA Mulla Vejsel (Xhelaludin) (1905-1986). Hoxhë, mësues, poet. Njihej edhe me emrat "Mulla Vejseli" dhe "Mulla Vejsel

Vojnoci”. Lindi në katundin Zaskoc të Ferizajt. Mësimet e para i ndoqi në mejtepin e fshatit, ndërsa më 1938 përfundoi Medresenë “Mehmed Pasha” në Prizren. Pas shkollimit, një kohë punoi si asistent në medrese dhe më pas detyrën e mësuesit të mejtepit e vazhdoi në katundin Vojnoc të Shtimes. Aty hapi edhe mejtepin e tij, në të cilin mësohej ilegalisht edhe gjuha shqipe. Gjatë viteve 1941-1945 mejtepi i V. Gutës u bë një shkollë kombëtare dhe fetare. V. Guta la pas një trashëgimi të pasur poetike, ilahi e kaside në gjuhën shqipe me grafi arabe. Shumë shkrime të tij u bënë tema mësimi nëpër mejtepe në Kosovë dhe më gjerë. Pas vrasjes së vëllait, Adem Gutës, nga komunistët më 1945, u detyrua të lërë Vojnocin dhe u vendos në katundin Hasan Beg, në rrethin e Shkupit, ku shërbeu si imam në xhaminë e fshatit deri në fund të jetës. (Resul Rexhepi)

GUXETA Antonino (Guzzeta) (1922-2017). Gjuhëtar, albanolog, profesor arbëresh. Lindi në Horën e Arbëreshëve në Sicili. Studioi në Universitetin e Palermos, ku filloi edhe karrierën e mësimdhënësit universitar. Më 1974 u zgjodh profesor ordinar në Universitetin e Napolit. Gjatë periudhës 1975-1994 drejtoi Institutin e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermos. Mbajti mësim edhe në Universitetin e Kalabrisë. Botoi në fushë të gjuhës dhe të letërsisë arbëreshe dhe shqipe. Ndër studimet e para të rëndësishme të tij është vepra në dy vëllime (i pari më 1968 dhe i dyti më 1973) “Gjurmë të shqipes së shekullit XV në dokumentet venedikase të kohës” (Tracec della Lingua albanese nel secolo XV nella documentazione veneta dell’epoca). Shkroi edhe për etninë shqiptare në Itali (1988) dhe për rolin e shkollës për mbrojtjen e kësaj etnie, (1988) si dhe për raportet arbëreshe-shqiptare (1989). Në studimet për arbërishten, veçohen studimet për të folmen e Horës Arbëreshe (1978), si dhe për atë të Kundsës (Contesa Entellina) (1983

dhe 1986). Organizoi kongrese dhe botime për albanologjinë në Palermo. (Ardita Berisha)

GYNTER Gert (?-?). Skenograf. I zënë rob luftime gjatë Luftës së Dytë Botërore. Prej vitit 1948 e deri në vitin 1954 ka qenë i angazhuar në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) si scenograf dhe si shef i realizimit skenik. Gjatë këtyre viteve ka dhënë kontribut shumë të çmueshëm në ndërtimin dhe në përshtatjen e skenës së TPK-së, si në trupën e Dramës Shqipe, ashtu edhe në Dramën Serbe. Ka realizuar skenografitë e një numri të madh të shfaqjeve të rëndësishme, në mesin e të cilave shquhen: “Deputeti i popullit” (1951), “I ndjeri” (1952), “Zona e Zanfirrit” (1952), “Monserat” (1953), “Proteksioni” (1953), “Personi i dyshimtë” (1953), “Ana Kristi” (1953), “Mbreti i Bretanjes” (1954), “Mirandolina” (1954) etj. Pas kryerjes së dënimit është kthyer në Gjermani. (Besim Rexhaj)

GYT Kristian (Christian Güt) (1931-). Studiuues francez, arkivist, historian, akademik, përkthyes. Lindi në Paris, ku studioi në “École Nationale des Chartes”. U doktorua për qytetërimin shqiptar në Universitetin e Puatjesë. Studiuues i fushave të ndryshme të shkencave albanologjike, ka merita për njohjen dhe përhapjen e kulturës shqiptare në vendet e frankofonisë. Ishte i ngarkuar me ligjërata për qytetërimin shqiptar (letërsi, histori, gjeografi) dhe me mësimdhënien e gjuhës shqipe (1966-1992). Botoi studime të ndryshme dhe librin “Pashko Vasa dhe alfabeti” (2006). Përktheu vepra letrare e studimore nga shqipja në frëngjisht, përfshirë autorë si Kadare, Agolli, Qosja etj. Përktheu në frëngjisht edhe Kanunin e Lekë Dukagjinit. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1996), profesor i jashtëzakonshëm i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit (1998), Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tiranës (2000) etj. (Pranvera Osmani)

GJ

GJAKMARRJA. Forma më e rëndë e hakmarrjes, e cila jashtë kontekstit të shoqërisë së organizuar politike konsiderohet si reagim i natyrshëm biologjik, si masë mbrojtëse dhe sigurie për vetvete dhe për të afërmit. Në shumë ambiente shoqërore gjithandej botës, por edhe në Kosovë, zakoni i lashtë i gjakmarrjes ka mbijetuar si pasojë e ngecjes së vetëdijes institucionale ndaj ndryshimeve në strukturën juridiko-politike dhe respektimin e ligjeve pozitive në shoqëritë e organizuara. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit gjakmarrja zë pothuajse vend qendror. Aty u kushtohet një kujdes i veçantë rrethanave, normave, formave të specifikuar dhe precize të nxitjes dhe të pajtimit. Kjo praktikë kanunore e gjakmarrjes ka mbijetuar jo vetëm në Kosovë, por sidomos në Veriun e Shqipërisë. Gjakmarrja si dukuri zakonore në këto mjedise ka mbijetuar jo për shkak të mungesës së funksionimit të shtetit juridik (edhe Kosova, por edhe Veriu shqiptar kanë shijuar pushtete me dozë paksa më të theksuar të etatizmit), por pikërisht nga fakti se shteti është përjetuar si i huaj dhe tepër i dhunshëm. Derisa Veriu i Shqipërisë vazhdon të ballafaqohet me pusitë, gjakmarrjen, ngujimet dhe pasojat e saj, që krejtësisht janë jashtë kohe, në Kosovë gjakmarrja nuk ka pushuar, por është zvogëluar. Fillimi i viteve '90 të shek. XX shënoi një fazë homogjenizuese të popullatës së deinstitutionalizuar shqiptare në Kosovë, e cila nga kërcënimi i përgjithshëm nga lufta me Serbinë krijoi klimë të favorshme për pajtimin e 2,000 gjaqeve dhe plagëve. Pjesa e Malësisë jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në një tubim të përfaqësuesve të formacioneve të traditës dhe aktivistëve shoqërorë e politikë, bëri Besëlidhjen në Tuz (më 28 qershor 1970) dhe me këtë akt e ndërpreu zinxhirin e gjakmarrjes. (Anton K. Berishaj)

GJAKOVA. Qytet në pjesën qendrore të Rrafshit të Dukagjinit, në anën e majtë të lumit Erenik, nëpër të cilin rrjedh lumi Krena. Qyteti është zhvilluar në rrugën kryesore Pejë-Prizren dhe



GJAKOVA

në rrugën e vjetër Via de Zenta, e cila me Qafën e Prushit lidhte pjesën veriore të Shqipërisë. Sot ka lidhje të mira rrugore me të gjitha komunat që e rrethojnë, si dhe me kryeqytetin e Kosovës (Prishtinën). Pozita e përshtatshme gjeografike dhe rëndësia strategjike mundësuan zhvillimin e shpejtë të këtij qyteti, me zejtarë dhe tregtarë mjaft të përparuar, me lidhje të mira tregtare me Shkodrën, Sanxhakun dhe vendet e tjera të Ballkanit.

Gjurmët e hershme të jetës në Gjakovë hasen që nga periudha iliro-dardane, ndërsa këtë e dëshmojnë rrënojat në anën perëndimore të Erenikut, përtej Urës së Tabakëve, që i përkasin qytetit antik Gabuleo të shek. I-IV. Në bregun e djathtë të Krenës, afër Gjakovës, ekziston një tumë e vetmuar. Deri në vitin 1582, Gjakova ishte fshat dhe qendër e tregut javor, ndërsa themelimi i qytetit lidhet me emrin e Hadum Sulejman efendisë, i njohur si Hadum-aga, i cili e ndërtoi xhaminë që u emërtua sipas

themeluesit (Xhamia e Hadumit). Zhvillimi i hovshëm i zejtarisë dhe tregtisë zgjati deri në vitin 1912, kur u izolua tërësisht nga përcaktimi i vijës kufitare me Shqipërinë. Në fillim të shekullit XX, Gjakova kishte 17,000 banorë, 16 xhami, 2 medrese, disa shkolla fillore, një bibliotekë, mbi 1,000 dyqane, hane, hamame etj. Ndërmjet dy luftërave botërore u ndërtua fabrika e tjegullave, ku punonin 100 punëtorë, mulliri dhe centrali elektrik, si dhe miniera e kromit në Devë. Pas Luftës së Dytë Botërore filloi formimi i kooperativave zejtare, tregtare, bujqësore etj. Kulmin e zhvillimit ekonomik Gjakova e arriti në periudhën 1974-1986, me rreth 22,000 të punësuar në industri dhe veprimtari të tjera ekonomike. Ndryshimet politike që ndodhën gjatë kësaj periudhe i dhanë impulse të reja zhvillimit të qytetit. Prosperiteti i hovshëm ekonomik dhe urban u reflektua edhe në ngritjen e shpejtë arsimore dhe kulturore. Themelimi i Shkollës së Lartë Pedagogjike (1968) shënon një kthesë të rëndësishme në ngritjen e Gjakovës si qendër e arsimit dhe e kulturës për të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi. U ngrit një numër i madh i institucioneve të veprimtarive të ndryshme shoqërore, ekonomike, administrative, arsimore dhe kulturore, që u shoqëruan edhe me ndërtimin e lagjeve të reja të qytetit e të komplekseve banesore dhe të disa objekteve me rëndësi shoqërore. Lufta e vitit 1999 Gjakovën e dëmtoi rëndë në aspektin popullativ dhe ekonomik. Regjistrimi i vitit 2011 tregoi rënie të konsiderueshme të numrit të banorëve (në vitin 2011 Gjakova kishte 40,827 banorë, kundrejt 41,899 banorëve në vitin 1981 dhe 12,724 banorë në vitin 1921). Që në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, kapacitetet industriale dhe ekonomike të Gjakovës pësuan rënie të ndjeshme, e cila vazhdoi edhe në vitet vijuese. Sot Gjakova është qendër rajonale nën administrimin e së cilës janë edhe dy komuna të tjera, Rahoveci dhe Malisheva. (Qerim Kastrati)

GJAKOVA (komuna). Komunë në pjesën perëndimore të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Shtrihet në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë, në Rrafshin e Dukagjinit, me sipërfaqe prej 587 km². Kufizohet në perëndim me Republikën e Shqipërisë, në jug me komunën e Prizrenit, në lindje me komunën e Rahovecit dhe në veri me komunat

e Pejës dhe të Deçanit. Komuna e Gjakovës ka pozitë shumë të mirë gjeografike, në qendër të Dukagjinit, ndërmjet dy qendrave të mëdha, Prizrenit dhe Pejës. Në pjesën më të madhe të territorit dominojnë kryesisht sedimentet liqenore dhe aluvionet, ndërsa në periferi shkëmbinjtë gëlqerorë dhe serpentinë. Relievi është kryesisht fushor, përkatësisht ultësira në mes lumenjve Drini i Bardhë dhe Ereniku, ku është ngritur qyteti i Gjakovës, ndërsa rrethina veçohet me forma më të ngritura, si suka e Cërmjanit, e Hereqit, Hasi, Çabrati dhe malet në kufi me Republikën e Shqipërisë. Forma të rëndësishme relievoje janë edhe qafat malore nëpër të cilat kalojnë rrugë të rëndësishme, që e lidhin Gjakovën me Shqipërinë, si Qafa e Kosharës, e Morinës, e Prushit dhe e Dobrunës. Dominon klima e modifikuar mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë, me temperaturë mesatare mujore 21.5^o C (korrik) dhe dimër të butë me temperaturë mesatare -0.9^o C (janar), ndërsa reshjet janë relativisht të mëdha 959 mm (vjetore). Territori i komunës është relativisht i pasur me ujëra: Drini i Bardhë, Ereniku, lumi Krena dhe Llukac. Në periferi, rreth 7 km larg Gjakovës, gjendet liqeni artificial i Radoniqit me sipërfaqe 64.4 km² dhe vëllim të ujit 113 mil/ m³, nga i cili furnizohet Gjakova e Rahoveci dhe ujiten rreth 10,500 ha tokë.

Nëpër territorin e kësaj komune qysh në kohën e lashtë kalonte rruga Via de Zenta, që ishte njëra ndër rrugët kryesore të Ballkanit, prej Shën Gjinit nëpër Prizren, deri në Nish dhe Konstandinopojë. Një pjesë e kësaj rruge, te Vau i Spasit, ndahej në dy drejtime, njëri kah që shkonte drejt Prizrenit dhe tjetri nëpër luginën e Krumës, nëpër Qafën e Prushit për në Gjakovë dhe Pejë. Gjatë gjithë historisë, Gjakova me rrethinë ka qenë e banuar me popullsi shqiptare, me shumicë absolute. Sipas regjistrimit të vitit 2011 në komunën e Gjakovës jetojnë 94,556 banorë, në 88 vendbanime, me dendësi mesatare prej 161 b/km².

Që herët degë kryesore e ekonomisë për komunën e Gjakovës ka qenë bujqësia, për shkak të kushteve të volitshme: toka pjellore, klima e përshtatshme dhe pasuria me ujëra. Pozita e mirë gjeografike në mes Prizrenit, Pejës dhe Shqipërisë më vonë i ka mundësuar edhe zhvillimin e zejtarisë dhe tregtisë. Komuna e Gjakovës disponon 55,684 ha tokë bujqësore, nga e cila, 15,000 ha janë ara e kopshte, 1,000 ha pemë dhe vreshta, 14,000 ha livadhe e

kulloso dhe rreth 25,000 ha pyje. Mundësi të riaktivizimit ka edhe industria ushqimore e cila ka vepruar në të kaluarën. Në zonat rurale bujqësia me rreth 70% është si burim i jetesës. Në periudhën 1975-1990, janë bërë investime të rëndësishme në industri, në të gjitha degët industriale. Tregtia është degë e rëndësishme për ekonominë e komunës, me theks të posaçëm tregtia e brendshme. Turizmi si degë e re ekonomike është në zhvillim e sipër, duke shfrytëzuar pasuritë natyrore dhe kulturore të Gjakovës dhe vendbanimeve të saj. (Qerim Kastrati)

GJAKOVA Agim (1935-). Poet, prozator, publicist. Lindi në Kavajë, Shqipëri, nga prindër nga Gjakova të emigruar në Shqipëri për të ndihmuar arsimin shqiptar. Më 1941 u kthye



AGIM GJAKOVA

në Gjakovë, bashkë me familjen, ku mbaroi shkollimin fillor e të mesëm dhe Shkollën Normale. Shërbeu si mësues në Lipjan dhe Mitrovicë, ndërsa më 1954 nisi studimet për romanistikë në Fakultetin Filozofik në Beograd. Si student ishte aktiv në shoqatën “Përpjekja”, organizatë e studentëve shqiptarë në Beograd. Si kundërshtar i politikës shoviniste ndaj shqiptarëve, u burgos tri herë nga regjimi jugosllav, përjetoi kampin e përqendrimit, heqjen e shtetësisë dhe në vitin 1960, pa arritur t'i përfundojë studimet, u dëbua në Shqipëri. Në Kavajë punoi për dy vjet mësues, më pas rinisi studimet për gjuhë angleze në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Mbas mbarimit të studimeve punoi si redaktor në Agjencinë Telegrafike Shqiptare (ATSH), pastaj skenarist në Kinostudion “Shqipëria e re”. Në qershor të vitit 1999, mbas 30 vjetësh, u kthye në Kosovë, ku vijoi punën e redaktorit në gazetën “Bota sot” deri në vitin 2006, kur doli në pension. A. Gjakova nuk u pajtua me shtrëngesat ideologjike në jetë dhe në art, kërkoi lirinë e individit dhe lirinë artistike, madje edhe format e lira të shprehjes metaforike në poezi e metonimike në prozë. Veprat kryesore të tij në poezi janë: “Kanga e Drinit të Bardhë” (1967), “Perspektivë” (1972), “Obelisk” (1985), “I gjuaj ëndrrat me gurë” (1995), “Deti” (1998), “Guxo e vdis” (1998), “Kufiri imagjinar” (2003), “Saga

flurore” (2008), “Dhe thonë se paqe ka në botë” (2010); ndërsa në prozë botoi: “Në kërkim të së vërtetës” (1976), “Dritëhijet e një qyteti” (1982) “Nën hijen e pavdekësisë” (1983), “Shtëpia në udhëkryq” (2003), “Herezi” (2006), “A ka kund Zot” (2009), “Loja e kafkave” (2009), “Korridorët e gjelbra” (2009), “Rrëfimet” (2014). Shkroi edhe drama dhe skenare, por u shqua edhe në publicistikë me veprën “Kosova edhe e shkrumueme është e hijshme” (2004). Jeton në Prishtinë. (Nysret Krasniqi)

GJAKOVA Ibrahim (1888-1975). Luftëtar i lëvizjes për pavarësi, për bashkim kombëtar dhe për Shqipëri demokratike. Lindi në Gjilan. Në vitin 1908 kreu akademinë ushtarake në Stamboll. Në kohën e kryengritjeve shqiptare 1910-1912 vepronte në Shkup. Në fund të nëntorit të viti 1912 u vendos në Vlorë, në detyrën e nëntogerit të xhandarmërisë. Shërbeu edhe në Elbasan deri në ardhjen e Princ Vidit. Me njësitin e tij të xhandarmërisë luftoi kundër grekëve kur ata sulmuan Gjirokastrën dhe Korçën. Ishte aktiv në Komitetin “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”. Më 1920 mori pjesë në Kongresin Kombëtar të Lushnjës. Me ardhjen e Nolit në pushtet, emërohet komandant i xhandarmërisë në Durrës, me gradën major. Pas rikthimit të Zogut, emigroi në Vjenë. Ishte njëri ndër organizatorët e Komitetit të Kosovës në Vjenë. Bashkë me Nolin mori pjesë në kremtimin e 10-vjetorit të Revolucionit të Tetorit në Moskë. Pas amnistisë nga Zogu, më 1930 u kthye në Shqipëri. Më 1939 refuzoi çdo bashkëpunim me pushtuesit italianë. Në vitin 1948 arrestohet në Durrës dhe e kthejnë në Jugosllavi. Pas gjyqimit, në mungesë të fakteve, lirohet dhe kthehet përsëri në Durrës, ku jetoi deri në fund të jetës. (Lush Culaj)

GJAKOVA Idriz (gjysma e dytë e shek. XIX). Luftëtar për çlirim kombëtar gjatë kohës së Lidhjes Shqiptare të Pejës kundër administratës osmane. Ishte njëri nga atdhetarët më me ndikim në trevën e Gjakovës. Më 16 shkurt 1900, pa marrë ende fund kryengritja e Dibrës, u organizua një manifestim në Shkup, i cili u kthye në kryengritje të armatosur. Kryengritësit kërkuan largimin e valiut të Kosovës, Mehmet Hafiz Pashës, të kryetarit të bashkisë dhe të funksionarëve të tjerë të administratës osmane në Shkup. Me kryengritësit shqiptarë u bashkua edhe popullsia sllave e Shkupit. Pushimi nga

sulltani më 13 mars të vitit 1900 i valiut të Kosovës, Mehmet Hafiz Pashës, ishte një fitore të kryengritësve. Por Porta e Lartë, megjithëse kishte shpallur amnistinë, arrestoi më 18 mars udhëheqësit e kryengritjes së Shkupit, Idriz Gjakovën, Haxhi Raufin dhe të tjerë, të cilët u dërguan në Bitlis. Këto masa u bënë shkak për një manifestim tjetër, që u organizua më 20 mars, në të cilin morën pjesë 3,000 kryengritës që kërkuan lirim të menjëhershëm të Idriz Gjakovës dhe udhëheqësve të tjerë të kryengritjes. Manifestimet që shpërthyen në Shkup në mars të vitit 1900 vijuan pa ndërprerje deri në vjeshtën e atij viti. (Alban Dobruna)

GJAKOVA Kurt-Mehmet Pasha (?-1727). Pushtetar dhe komandant ushtarak osman. Ishte i biri i Hasan Pashë Gjakovës, kryefamiljar i oxhakut të Kryezinjve. Mori gradat e Pashës si pjesëmarrës i luftërave austro-osmane. Në vitin 1703 ishte i implikuar në trazirat që u zhvilluan në Stamboll, që shfronësuan sulltan Mustafën II dhe sollën në fron sulltan Ahmetin III. Nga ky vit ka qeverisur si sanxhakbej në disa sanxhaqe shqiptare, si në Elbasan, në Shkodër etj., ndërsa në vitin 1708 u emërua sanxhakbej i Prizrenit. Në vitin 1716 u emërua mytesarif i Elbasanit, ndërsa në vitin 1717 mori pozitën e sanxhakbeut të Shkodrës. Derisa ishte në këtë pozitë, venedikasit me 30,000 trupa e sulmuan Ulqinin, por i zmrapsi ata dhe u shkaktoi disfatë të rëndë. Fitores së Kurt-Mehmet Pashës kundër venedikasve, poeti shkodran me banim në Gjakovë, Sylejman Axhiz Baba ia kushtoi një poezi lavdëruese në divanin e tij, ndërsa në shenjë kujtimi të kësaj fitoreje skaliti një mbishkrim në muret e kalasë së Ulqinit, i cili gjendet edhe sot. Gjatë viteve 1721-1727 ai qe mytesarif i Dukagjinit. Vdiq në vitin 1727. Djali i tij, Adem Pasha, ishte sanxhakbej i Ohrit (1694), i Elbasanit (1696), i Ohrit (1697) dhe sanxhakbej i Shkodrës (1699); djali tjetër, Abdullah Pasha, ishte sanxhakbej i Prizrenit (1742), i Shkodrës (1745-1749), i Prizrenit (1750) dhe për të katërtën herë sanxhakbej i Shkodrës (1754); ndrysa djali tjetër, Ali Pasha ishte sanxhakbej i Dukagjinit një kohë të gjatë (vdiq më 1745). (Nehat Krasniqi)

GJAKOVA Mahmud Pashë (?-1697). Pushtetar dhe komandant ushtarak osman. Ishte i biri i Hasan Pashë Gjakovës, kryefamiljar i oxhakut të Kryezinjve. Në burimet osmane njihet si

Mahmud Pashë Gashi dhe si Mahmud Pashë Gega. Para rrethimit të Vjenës (1683) ishte zëvendës i bejlerbeut të Budimit, vezirit Koxha Arnaut Ibrahim Pashës nga Skrapari. Në vitin 1688 u emërua sanxhakbej i Hercegovinës. Nga fundi i vitin 1889 mori detyrën e sanxhakbeut të Dukagjinit dhe në këtë cilësi, si komandant i këtij sanxhaku mori pjesë në luftimet kundër forcave austriake në kapërcyellin e shek. XVII. Para vitit 1694 ishte bejlerbej i Rumelisë, ndërsa pas rënies në luftë të Mahmud Pashë Mahmudbegollit të Pejës, në vitin 1695, bëhet mytesarif i Prizrenit dhe i Dukagjinit, pozitë në të cilën qëndroi një vit. Vdiq në vitin 1697. Mahmud Pasha ka ndërtuar xhaminë dhe mejtepin në qendër të Gjakovës që mban emrin e tij. Edhe bijtë e tij Gazi Sylejman pasha, Kapllan Pasha, Hasan Pasha dhe Hysejn Pasha kanë qenë personalitete aktive në jetën politike të kohës. Sylejman Pasha dhe Hysejn Pasha janë vrarë në luftë kundër rusëve, duke e mbrojtur kështjellën Oçakov, në vitin 1737. Ndërsa Hasan Pasha, i biri i Mahmud Pashës, ka pasur pozitën e sanxhakbeut të Prizrenit (1745-1747 dhe 1748-1749). Nipi i Mahmud Pashës, Mahmud Pasha II, i biri i Kapllan Pashës, kishte pozitën e sanxhakbeut të Shkodrës në vitin 1731. (Nehat Krasniqi)

GJAKOVA Murad Beg (?-1748). Pinjoll i familjes Kryeziu nga Gjakova, themelues institucionesh arsimore dhe fetare të periudhës osmane. Lindi në Gjakovë në çerekun e fundit të shek. XVII. I ati, Adem Pashë Gjakova, i biri i Mehmed Kurt Pashës, ka qenë mytesarif në disa sanxhaqe shqiptare. Murad Beu ndërtoi Medresenë e Madhe të Gjakovës në vitin 1707, ndërsa në vitin 1714 ndërtoi Teqenë e Madhe. Ishte po ashtu themelues i bibliotekës së Medresesë së Madhe. Për nevojat e myderrizëve dhe të vijuesve të medresesë bleu shumë vepra dhe kopjoi një numër syresh. Zgjidhi për mësimdhënës të medresesë Ali efendi Perën nga Gjakova dhe Yvejs Efendiun nga Shkodra, ndërsa shehu i parë i Teqesë së Madhe ishte Sylejman Axhiz Baba, po nga Shkodra. Murad Beu ishte mecen i dijetarëve dhe i intelektualëve të kohës. Ishte njeri i ditur dhe i penës, që vërtetohet nga dorëshkrimet që ruhen në disa koleksione në Prishtinë, Gjakovë, Sarajevë e gjetiu. (Nehat Krasniqi)

GJAKOVA Nora (1992-). Xhudiste. Lindi në Pejë. Nisi të merret me sportin e xhudos në moshë të re. Garon në kategorinë deri në 57 kg, kurse suksesin më të madh e arriti në




NORA GJAKOVA

Lojërat Europiane që u mbajtën në Baku të Azerbajxhanit në vitin 2015, ku fitoi medaljen e bronzte. Medaljen e bronzte e fitoi edhe në Kampionatin European në Kazan (2016). Mban edhe një vend të shtatë në botërorin e vitit 2013, është kampione e Europës për xhudistet deri në 23 vjeç nga viti 2014, ndërsa fitoi medalje në shumë turne e gara prestigjioze të xhudos. Është pjesë e klubit "Ippon" nga Peja. Një kohë garoi edhe për Shqipërinë, kur Kosovës nuk i lejohej paraqitja në gara europiane e botërore. (Tahir Sopi)

GJAKOVËS (E FOLJMA E). Bën pjesë në nëndialektin verior të gegërishtes, në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Përveç tipareve të përbashkëta të gegërishtes, ka dhe veçori më specifike, si shkrirja e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd* (mbuloj-mloj, i ndihmoi-i nimoi); mbaresa *-i* dhe jo *-u* tek emrat e lakimit të dytë (miku-miki, krahu-krahi) etj. Bashkëtingëlloret palatale *q*, *gj*, në të folmen e Gjakovës, si kudo në gegërishten verilindore, janë zëvendësuar me afrikatet *ç*, *xh*. Disa nga paraqitjet e zanoreve në këtë të folme janë: zanorja *a* kthehet shpesh në të përparme, *a-ä*, (*fjalë-fjā:l*). Nuk ka zanore ë në pozitë të patheksuar: *dRa:s* (*dërrasë*), / *pRra:l*/ etj. Në rasën gjinore dhe dhanore, kjo zanore kthehet në *e*, p.sh. *rrugës-rruges* etj; ë-ja kthehet në *i*, p.sh. *lëvore-livore* etj. Zanorja *i* kthehet në disa fjalë në *y*, si: *rrip-rrÿp*, *kripë-krÿp* etj. Zanorja *o* në disa fjalë kthehet në *a* *portokall-partakall*, *oborr-aborr*. Zanorja *u* në disa raste kthehet në radhë të përzier: *i terur-i terën*, *flutur-flutër* etj. Ndërsa zanorja *y* kthehet në *i* në disa raste: *bylmet-bilmet*. Togu vokalik *-ie* është asimiluar në *-i*, p.sh. *dielli-dilli*, *mielli-milli* etj. Karakteristikë është nyjëtimi i bashkëtingëlloreve dridhëse si kakuminale, fricative. Për studimin e të folmes së Gjakovës kanë dhënë kontribut studiuesit shqiptarë, si: E. Çabej, S. Riza, I. Ajeti etj. (Agesa Hasimja)

GJATA Mehmet (1952-). Gazetar. Lindi në fshatin Bajçinë të Podujevës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen në Podujevë, ndërsa Fakultetin Juridik, degën e gazetarisë, në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1978 nisi të punojë gazetar në të përditshmen "Rilindja", më pas reporter dhe për shumë vjet redaktor i rubrikave të ndryshme. Pas mbylljes së "Rilindjes" (1990), punoi në gazetën e revistat "Bujku", "Shkëndija" dhe "Zëri" deri në vitin 1993, kur emërohet kryeredaktor në gazetën "Rilindja", botimi i Tiranës. Pas luftës, nga 1999 deri më 2009, punoi redaktor në gazetën e përditshme "Zëri" dhe nga viti 2009 deri më 2013 redaktor në gazetën "Koha ditore" dhe në portalin "Koha.net". Nga viti 2014 vazhdon të jetë kryeredaktor i revistës "Ekonomia", që botohet në Prishtinë. (Veli Bytyçi)

GJEÇOVI Shtjefën (1874-1929). Shkrimtar, publicist, përkthyes, klerik, etnograf, arkeolog. Atë Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Konstandin Gjeçi - Kryeziu) lindi në Janjevë. Mësimet e fillores i kreu në vendlindje. Më 1884 hyri në Kolegjin Farnçeskan të Troshanit (Vilajeti i Shkodrës). Më 1888, pas përfundimit të kolegjit, shkoi në kuvendin e Fojnicës (Bosnjë). Vijoi mësimet në Derventë, në Banjalukë. Mësimet teologjike i kreu në Kreshevë. Më 1896 u caktua meshtar në Troshan. Aty e mori emrin e ri Shtjefën-Kostandin. Shërbeu në Rubik dhe më 1897 u transferua famullitar në Zllakuqan të Klinës. Ishte mësues i shkollës së parë shqipe të Zllakuqanit. Vazhdoi të punojë edhe në vise të tjera: në Laç të Kurbinit (rihap shkollën shqipe), në Gomsiqe të Mirditës, në Durrës, në Vlorë, në Shkodër dhe, si mësues i shqipes, në Arbënesh të Zarës (1905). Në vitet e fundit të jetës u kthye me punë në Zym të Hasit. Më 1929, për shkak të veprimtarisë patriotike, arsimore dhe kulturore u vra nga serbet në Kodrën Rrezin të Zymit të Hasit të Thatë. Veprimtaria e Sh. Gjeçovit përfshin shumë vepra të botuar dhe dorëshkrime. Veprat e tij të botuara janë: "Kanuni i Lekë Dukagjinit ner Malcina t'Mdhaa", botuar në vazhdime në revistën Albania (1898-1899); "Dashtunia e atdheut", (dramë, 1901); "Jeta e Shën Luçisë pajtores s'arkidioçezit të



SHTJEFËN GJEÇOVI

Durrësit” (1904); “Agimet e Gjytetnisi, vepër morale didaktike (1910); “Shqiptari ngadhënjyes”, vepër e pabotuar (1904); “Princi i dy Dibrave apo Mojsi Golemi” (1904), Mënera e Prezës”, novelë (1902); “Tradhti gjaksore (Vrasja e Mark Kulit)” (1906); “Përkrenarja e Skënderbeut” (1914). Shkroi edhe me pseudonime, ndërsa përktheu: “Vajza e Orleansit ose Joana d’Ark” (1916); “Shna Nou i Padues”, sipas A.N. Dal Gal (1912), “Atil Reguli”, dramë e Pietro Matastazit (1912), “Quo vadis”, roman i H. Sinkjeviçit (1923). Gjithashtu përktheu “Fjalë e urta” të Sokratit (1921) dhe disa vepra fetare. Mblodhi thesarin popullor nga kultura materiale dhe shpirtërore, shumë objekte arkeologjike dhe formoi muzeun françeskan, ku ekspozoi ekspozitat të rëndësishme muzeore, armë, veshmbathje dhe gjësende të tjera të rralla. Veçmas u vlerësua përmbledhja e tij dhe mbarështrimi për veprën “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. (Isak Shema)

GJEÇOVI Xhelal (1940-). Historian. Lindi në Shkodër, ku përfundoi edhe shkollën e mesme. Studimet i kreu në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (1968). Punoi si pedagog i historisë dhe i filozofisë në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike. Në vitin 1979 kaloi me punë në Institutin e Historisë si punonjës shkencor. Nga viti 1997-2005 ishte përgjegjës i sektorit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe zëvendës drejtor i Institutit, ndërsa më pas u caktua përgjegjës i departamentit të historisë së Kosovës në këtë Institut. Është autor i disa monografive kushtuar periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe periudhës pas saj: “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës së Dytë Botërore”(1986), “Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës” (1998), “Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri” (1999), “Pushtimi gjerman në Shqipëri” (2004) etj. Është bashkautor dhe redaktor i vëllimit IV të “Historisë së popullit shqiptar”. Gjithashtu ka botuar artikuj të shumtë në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Teki Kurti)

GJELLTARIA POPULLORE. Është mjeshtëria tradicionale e gatimit, e cila, në varësi nga kushtet dhe rrethanat ekonomike, krijon traditën e ushqimit dhe përcakton llojin e ushqimit më të përdorur. Ndër shqiptarë buka ka qenë baza kryesore e ushqimit të

përditshëm, prandaj, si rrjedhojë, në treva të ndryshme të Kosovës gjejmë lloje të ndryshme të bukës me emërtime sipas mënyrës së gatimit, të përmbajtjes, apo të enës ku piqet buka: bukë mrume, bukë masdore, bukë tepsie, bukë t`rubave, bukë nore, bukë pogaçe, bukë kollomoçe ose e kollomajtë, bukë çerepi, bukë n`prush, bukë simite etj. Në shumë krahina etnografike njihet kulaçi, si lloji i bukës me përbërje dhe shije të ndryshme, me emërtimet: kulaçi i ndrikullës, kulaç shtegtimi, i ngjeshun, i nuses, i çobanit, kuleç t`pitës, kuleç t`bijave, t`Shëngjergjit, t`Natës Madhe (natë Bajrami, natë e qirave) etj. Ushqimet prej brumi me bazë miellin e grurit ose të misrit, gjithashtu janë të përhapura dhe të shumëllojshme: trajte, trejte, pite, peta dhe petas, tepsia, laknorë, petulla, kryelanë, flija, t`gatume, m(e)rende, kungullor, bakllasarme, kollpite, përpeq, mantia etj. Gjellëtaria popullore karakterizohet edhe me përdorimin e prodhimeve të qumështit: djathi, kosi, maza, gjiza, hirra, dhalla, kumshti, ajrani, lëngu. Ndër ushqimet nga mishi do përmendur pastërma, e cila përgatitej kryesisht në sezonin dimëror, sikundër që njihen edhe gjellë me bazë bimore, të kombinuara me mish. Edhe ëmbëlsirat kanë traditë të përdorimit, por më shumë në jetën urbane, siç janë: tatlia ose tepsishtja, sheqerparja, revania, bakllavaja, hallva, tomëlorizi etj. Disa ushqime nga gjellëtaria popullore janë zhdukur, disa ruhen si traditë, të tjerat vazhdojnë të kenë përdorim të përditshëm, kurse një pjesë është përhapur në bizneset ushqimore, në furra dhe restorante. (Lumnije Kulinxha-Kadriu)

GJENOCIDI SERBO-MALAZEZ MBI SHQIPTARËT (1912-1913). Vrasje masive të shqiptarëve gjatë pushtimit të Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi në vitet 1912-1913. Pushtimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare nga mbretëritë e Serbisë dhe Malit të Zi dhe aneksimi i këtyre tokave me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913) u përcoll me masakra dhe vrasje ndaj popullatës civile shqiptare. U dogjën fshatra e qytete, u vranë dhe u masakruan burra, gra, pleq dhe fëmijë. Për shkak të dhunës sistematike, mijëra shqiptarë u larguan nga vatrata e tyre. Burgjet e Kosovës dhe të viseve të tjera ishin mbushur me shqiptarë. Sipas një raporti të Argjipeshkvit të Shkupit, Lazër Mjeda, gjatë invadimit të vilajetit të Kosovës

nga ushtritë serbe dhe malazeze ishin vvarë rreth 25,000 shqiptarë. Për veprime gjenocidale ndaj shqiptarëve raportoi edhe shtypi shqiptar dhe ai i huaj, ndërsa Leo Frojndlihi i përshkroi ato në një broshurë me titull “Golgota shqiptare 1913” (Albaniens Golgotha, 1913) Masakrat e kryera nga ushtria serbe në Anamoravë, në Prishtinë, në Prizren, në Lumë, në rrethin e Dibrës etj., kishin karakterin e spastrimit etnik në përmasa të gjëra. Akte të gjenocidit u shënuan edhe në Plavë, Guci, Rugovë, Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog etj. Ato u përsëritën edhe gjatë dhe pas kryengritjes së shtatorit të vitit 1913. Shtypi socialdemokrat serb atë kohë raportonte nga vendi i ngjarjes për reprezaljet e ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve. Një ushtar serb përmes gazetës “Radničke novine” bënte të ditur se: “Ka fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë, dyqind shtëpi ku nuk ka më asnjë burrë”. Kosta Novaković ka deklaruar se pushtimi serb i Kosovës vetëm në vitet 1912-1913 shfarosi më shumë se 120,000 shqiptarë, ndërsa nën pushtimin malazez u vranë rreth 30,000 sish. (Isa Bica)

GJERAKU Vezire (1923-). Mësuese veterane. Lindi në Prishtinë, ku kreu edhe shkollën fillore. Në vitin 1942 diplomoi në Institutin femnor “Nana e Skënderbeut” në Tiranë, pastaj u kthye në Prishtinë dhe punoi si mësuese deri në vitin 1946, kur për shkak të veprimtarisë atdhetare në Kosovë, u detyrua të kthehet sërish në Shqipëri. Për kontributin e saj në arsimin shqip në Kosovë, mësuesja V. Gjeraku mori mirënjohje dhe dekorata. (Linda Salihu)

GJERAVICA. Mal në Bjeshkët e Nemuna, maja më e lartë e Kosovës (2,656 m). Shtrihet në skajin jugperëndimor të Bjeshkëve të Nemuna, afër kufirit me Shqipërinë. Gjeravica përkufizohet me luginat e sipërme të Erenikut në jugperëndim, të Bistricës së Lloçanit në verilindje dhe të Bistricës së Deçanit në veriperëndim. Gjeravica ndërtohet nga diabaze dhe gabbro të metamorfizuara me paraqitje të konsiderueshme të depozitimeve akullnajore (morenave). Karakterizohet me reliev të thepisur alpin, ku veçohet maja piramidale me shpate të thikta, që përfundojnë në cirqet dhe lugjet akullnajore. Në Gjeravicë paraqitet një numër i liqeneve akullnajore. Liqeni i Madh është në lartësi 2,320, ka gjatësi 240 m, gjerësi 120 m, thellësi 3.8 m, ndërsa Liqeni i Vogël është

me formë të rrumbullakët, me diametër rreth 100 m dhe gjendet në lartësi rreth 2,360 m. Nga Liqeni i Madh buron lumi i Erenikut. Gjeravica paraqet një destinacion të rëndësishëm turistik dhe të bjeshkatarisë. Në pjesën e poshtme është e mbuluar nga drurët dhe gërmushat; në pjesën e mesme nga dushku, ahu, gështenja, rrobulli, arneni dhe pishat. Mbi 2,000 m lartësi shtrihen kullotat alpine, ndërsa majat e larta mbi 2,400 m janë të zhveshura. (Vahdet Pruthi)

GJERGJA Gjuzep (Josip) (1937-). Basketbollist-trajner. Lindi në Zarë të Kroacisë. Rrjedh nga një familje me prejardhje arbëneshe. Gjatë periudhës 1960-1970 ishte një prej basketbollistëve më të mirë të “Zarës” dhe të ish-Jugosllavisë. Njihet edhe me emrin Josip Gjergja. Ishte një nga lojtarët e mëdhenj të KB “Zara”, së bashku me arbëneshin tjetër, Kreshimir Qosiq. Pesë herë u stolis me titullin e kampionit të ish-Jugosllavisë. Gjatë periudhës së pasluftës në Kosovë, Gj. Gjergja për një kohë drejtoi KB “MEB Prishtina” (2002) dhe më pas edhe KB “Mabetex” (2003) dhe ndihmoi në avancimin e basketbollit të Kosovës. (Besim Kajtazi)

GJERGJAJ Gjon (1951-). Shkrimtar. Lindi në Krushevë të Vogël të Klinës. Filloren dhe gjimnazin i kreu në Klinë. Shkruan për fëmijë dhe për të rritur, poezi dhe drama. Botoi krijime letrare që nga vitet '60. Deri në vitin 1990 punoi në Klinë. U mor me aktrim, skulpturë, etnografi etj. Veprat e botuara: “Lisat e Nakllit” (1989), “Bukuroshja e detit” (1992), “Kroje ëndrrash trëndafili” (1992), “Lulja që i priu detit” (1994), “Shembje sfinksash” (1997), “Ninullë e blertë” (1997), “Përralla ka atdhe” (1997), “Kali i Shtrigës” (1998), “Përralla ka grevë urie” (2000), “Karazuzari” (2002), “Edhe dhia do tagji” (2002), “Kameleonët zbresin shkallëve të Parajsës” (2004), “Feniks zjarresh” (2005), “Lepurushi i gjyshit” (2005), “Vjersha me mjaltë” (2008), “Ëndrra e dritës” (2013), “Lëngu i fikut” (2013), “Dy drama” (2014), “Doruntina në rrugën e pikëllimit” (2014) etj. (Munish Hyseni)

GJERGJI Dom Gjergj (1948-). Prift, historian. Lindi në Stubëll, shkollën fillore e kreu në Stubëll e Zhegër, gjimnazin klasik në Suboticë të Vojvodinës. Në Romë përfundoi studimet për filozofi dhe teologji (1974). Po

këtë vit u shugurua prift në vendlindje. Kreu studimet e magjistraturës dhe doktoratës në shkencat historike-dogmatike në Universitetin “Urbaniana” të Romës (1987). Si prift ka shërbyer në Maqedoni, Kosovë, Itali dhe Shqipëri. Në Shqipëri, në Tiranë dhe Elbasan, shërbeu edhe si misionar i motrave të “Nënë Terezës” (1991-1999). Ka botuar një sërë veprash shkencore dhe fetare, ndër të cilat: “Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848” (1994), “Kosova - altari i Arbërisë” I,II,III (1997), “Vatikani dhe Arbëria 1700-1922” (1998) etj. Ka botuar shumë artikuj shkencorë nga fusha e historisë dhe ka në dorëshkrim edhe vepra të tjera shkencore. Jeton në Stubëll. (Sarë Gjegi)

GJERGJI Dom Lush (1949-). Titullar i Kishës Katolike, humanist, biograf i Nënë Terezës. Lindi në Stubëll të Epërme, Viti. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, në Viti dhe në Zhegër,



DOM LUSH GJERGJI

gjimnazin klasik në Dubrovnik, ndërsa studimet i filloi në Split dhe i përfundoi në Universitetin Papnor “Urbaniana” në Romë (1973). Njëkohësisht studioi edhe në Universitetin “La Sapienza” të Romës, ku u doktorua në psikologji (1975). Për shumë vjet ishte redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetare-kulturore “Drita”, si dhe i shtëpisë botuese katolike me të njëjtin emër, një kohë në Ferizaj, më vonë në Prizren dhe tani në Prishtinë. Ka shërbyer si famullitar në Ferizaj, në Binçë dhe në Prizren. Gjatë viteve ’90 zhvilloi aktivitet të dendur në pajtimin e gjaqeve, propagandoi bashkëjetesën fetare në Kosovë dhe u përfshi gjerësisht në veprimtari humanitare përmes shoqatës “Nënë Tereza.” Është anëtar i disa asociacioneve të shkrymtarëve dhe të gazetarëve brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar një numër të madh veprash me karakter fetar dhe shoqëror, monografi, përshpirtëri etj., nga të cilat veçohen një sërë botimesh për Nënë Terezën: “Nëna jonë Terezë” (1980, botuar edhe në kroatisht, sllovenisht, italisht, frëngjisht, spanjisht, hungarisht dhe anglisht), “Lule për Nënë-monografi kushtuar Nënës Terezë” (1986), “Dashuria në vepër: Nënë Terezë” (1992), “Gonxhja jonë-Nëna e botës” (1998), “Nëna e dashurisë” (2000), “Gonxhe Bojaxhiu-Nënë

Tereza”, “Shenjtëresha e dashurisë-Nëna Terezë” (1998, poezi dhe uratë), pastaj monografinë për imzot Nikë Prelën dhe një sërë veprash fetare. Aktualisht është vikar gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës në Prishtinë. (Ndue Ukaj)

GJERGJI Imzot Dodë (1963-). Titullar i Kishës Katolike, ipeshkëv i Kosovës. Lindi në Stubëll të Epërme të Vitisë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje dhe Ferizaj, ndërsa gjimnazin klasik në Suboticë (Serbi).



IMZOT DODË
GJERGJI

Më 1989 mbaroi studimet për teologji dhe filozofi dhe po atë vit u shugurua meshtar në Zym të Hasit, Prizren. Gjatë viteve 1991-1994 shërbeu në Misionin Katolik Shqiptar në Kroaci, ndërkohë themeloi Misionin Katolik Shqiptar në Austri. Në vitin 1994 u dërgua në Shqipëri, ku dha kontribut të çmuar në mëkëmbjen e Kishës Katolike. Në vjeshtën e vitit 1999 u emërua administrator apostolik në Dioqezën e Sapës, ndërsa në vitin 2000 mori detyrën e ipeshkëvit të dioqezës. Po atë vit u zgjodh sekretar i përgjithshëm i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë. Drejtoi komisionin e kësaj Konference për ekumenizëm dhe dialog ndër fetar. Nga konferenca e ipeshkvijve u zgjodh kryetar i këshillit për krenntimin e 2000 vjetorit të krishterimit ndër shqiptarë dhe përfaqësoi Shqipërinë në Këshillit e Konferencave Ipeshkvnore të Europës. Në vitin 2002 u zgjodh president i “Caritas-it” shqiptar. Më 2006 u shugurua ipeshkëv i Sapës, në katedralen e Sapës, ndërsa në dhjetor të atij viti u emërua administrator apostolik i Prizrenit, ipeshkëv i Kosovës. Dha kontribut në aktivitetet humanitare dhe në dialogun ndër fetar. Ishte redaktor i revistës së misioneve “Rrezja” dhe bashkëpunëtor i përhershëm i revistës “Drita”. Është autor i librit udhërrëfyes baritor “Shërbejmë me përvujtëri e kumtojmë me hare”. (Ndue Ukaj)

GJERGJI Rexhep (1956-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në fshatin Obrançë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin matematikor në Prishtinë. Diplomoi në degën e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1980. Dy vjet punoi në gjimnazin “Sami Frashëri” në



REXHEP GJERGJI

Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit e mbrojtë në FSHMN të UP-së (1987). Në vitin 1982 zgjidhet asistent në FSHMN dhe në vitet vijuese ngrihet në të gjitha gradat universitare dhe më 2004 bëhet profesor ordinar. Për qëllime studimore ka qëndruar në Universitetin e Heidelbergut në Gjermani (1986-1987). Ka marrë pjesë në tubime shkencore të matematikanëve në vend dhe në botën e jashtme. Ka botuar punime shkencore në revista ndërkombëtare e vendore dhe është autor i disa teksteve për shkollën të mesme dhe teksteve universitare (“Algjebra e përgjithshme - përmbledhje detyrash të zgjidhura” I, II, “Kurs i përgjithshëm nga matematika” etj.). Ka qenë anëtar i kryesisë së LDK-së (1990-1998) dhe deputet i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës (1998-2001). (Minir Efendija)


GJERGJI Sarë (1965-). Shkrimtar. Lindi në Stubëll të Epërme të Vitisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Viti, ndërsa studimet për letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Më pas vijoi studimet pasuniversitare dhe ato të doktoratës në Universitetin e Shkupit. Disa vjet punoi në arsim, pastaj udhëhoqi shoqatën “Karitas” të Republikës Çeke në Gjilan, ndërsa më vonë kreu punën e përgjegjës të zyrës për informim të komunës së Vitisë. Ka qenë botues dhe kryeredaktor i revistës “Lajmëtar” (Graz), kryeredaktor i revistës “Identiteti” (Prishtinë), redaktor përgjegjës i revistës “Kalendari letrar” (Prishtinë) dhe organizator i manifestimit letrar “Takimet e Dom Mikelit”. Me shkrime letrare, kryesisht me poezi, është marrë që i ri. Deri më tani ka botuar këto vepra: “Golgotë” (1994), “Kontrast ngjyrash, Prometheus” (1996), “Terapia e vdekjes - requiem për Kosovë” (2000), “Peizazh toke” (2004), “Dashuri e pambarim” (2007), “Legjenda e tërfilit” (2012), “Stublla me shkollën e parë shqipe 1584-1905” (2014). Në vitin 2007 i është botuar në gjuhën rumune përmbledhja “Zjarr i pashuar”. (Munish Hyseni)

GJERGJIZI Abdylhalim (?-1906). Myderriz, myfti, veprimtar politik dhe pjesëmarrës i

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe i Lidhjes së Pejës. Njihet si myderriz i parë i medresesë së Sinan Pashës në Prizren. Ka dhënë mësimë edhe në Medresenë e Mehmet Pashës po në Prizren. Ishte predikues në Xhaminë e Sinan Pashës dhe myfti i Prizrenit. Ka qenë aktivist i dalluar dhe anëtar i Këshillit Qendror të Lidhjes së Prizrenit. Për shkak të veprimtarisë së tij patriotike u dënua nga qeveria osmane me një vit burg të rëndë dhe pastaj me internim në Nablus të Shamit. Pas internimit pati rol të rëndësishëm edhe në formimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës. Ishte kryetar i Komitetit Shqiptar për sanxhakun e Prizrenit. Ka qenë edhe kryetar i Këshillit për Lidhje të Besës të sanxhakut të Prizrenit. (Sadik Mehmeti)

GJERMANIZMAT. Bëhet fjalë për huazime nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe. Një pjesë e madhe e huazimeve të gjermanishtes i përket sferës së teknikës dhe të mekanikës. Në gjuhën shqipe, sidomos në Kosovë, ka dy rrugë kryesore për të huazuar nga gjuha gjermane. Në njërin anë kemi huazimet nga mërgimtarët shqiptarë në Gjermani dhe konceptet e fjalët që ata sjellin prej atje. Nga ana tjetër, kemi huazimet përmes gjuhëve të ndërmjetme. Huazime të llojit të parë mund t'i konsiderojmë fjalët si krikëll (*Krängel*-gotë e birrës), ybercuk (nivelizimi në ndërtimtari), ose ndryshimet fonetike: fusball ose ojro (për euro). Nga huazime të llojit të dytë kemi të bëjmë me fjalë që kanë hyrë kryesisht përmes serbishtes: frajer, shinter, shuster, shnajder, shrafciger, feler, shllag, gasterbajter. Një pjesë e tyre kanë marrë kuptime të tjera në serbishten dhe prej andej edhe në shqipen. Disa gjermanizma i përkasin jetës së fermave të kuajve, për shkak të pranisë së pakicës gjermane në Banat, prej nga edhe janë ato huazime (po e zëmë cyrik). (Milote Sadiku)

GJERQEKU Enver (1928-2008). Poet, akademik. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet e larta në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Beograd ku mbaroi dhe studimet pasuniversitare (1961). Pjesën më të madhe të viteve të punës i kaloi mësues në Shkollën Normale të Gjakovës dhe në Normalen e Prishtinës, si dhe profesor në katedrën e albanologjisë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Poezinë e parë e botoi në vitin 1946. Nga gjysma e dytë e viteve '50 botoi vëllimet



ENVER GJERQEKU

me poezi: “Gjurmat e jetës” (1957), “Bebzat e mallit” (1960), “Blerimi i vonuem” (1966), “Tinguj të zgjuam” (1966), “Ashti ynë” (1972), “Xixa stralli” (1976), “Pengu” (1977), “Lumi i palodhur” (1978), “Pengu i dashurisë” (1978), “Sogjetar amshimi” (1982), “Flatrimi i fjalës” (1987). Lirika e Enver Gjerqekut qëndron mirë në kohën e vet letrare të Kosovës, por edhe sot në tërësinë e poezisë shqipe. Emancipuese tingëllonte edhe në kuadër të lirikës jugosllave të kohës së vet, hapësirë në të cilën pjesa më e madhe e poezisë së tij ishte e përkthyer. Në fillimet e veta, edhe pse entuziaste, që ishte frymë e përgjithshme, poezia e tij ishte e përmbajtur dhe në vend të lavdeve, fitores, sjell imazhet e ekzistencës së rëndë të popullit të vet në të kaluarën. Poeti e ndjen se duhet kohë për të shëruar vragët e lënë në trupin kolektiv shqiptar në këtë hapësirë. Kjo ndjenjë, me nuanca melankolie do të shquhet sidomos te vëllimi “Blerimi i vonuam”. Me kohë, kur sa vinte dhe ngushtohet hapësira e frymëmarrjes së lirë për Kosovën shqiptare, edhe poezia e tij, sado diskretshëm, nuk mund ta fshihte shqetësimin e thellë. Droja për të papriturat kërcënuese që i parandiente shqisa e poetit, për atë që do të pasonte më vonë mbi Kosovën, vinin paralajmërim diskret, duke filluar sidomos që nga vëllimi poetik “Ashti ynë”, “Xixa stralli” dhe në vazhdim. Duke i mbetur besnik deri në fund të jetës vokacionit poetik, ai mbetet autori më i njohur në kultivimin e vargut të disiplinuar. U shqua sidomos në fushën e sonetit dhe, në atë të kurorës sonetike. Poezia e E. Gjerqekut u përkthye dhe u botua në shumë qendra republikane të ish-Jugosllavisë. Edhe E. Gjerqeku ka sjellë në gjuhën shqipe shumë kryepoetë nga këto qendra të asaj kohe. Ishte laureat i shumë dekoratave dhe çmimeve letrare-poetike në Kosovë dhe jashtë saj. (Ali Aliu)

GJETO Leka (1922-1988). Gazetar. Lindi në Tuz të Malit të Zi. Pasi punoi një kohë në arsim, u bë gazetar i TV Beogradit dhe më pas u përfshi në redaksinë e emisionit në gjuhë shqipe “Pasqyra televizive” (1966). Ishte gazetar dhe redaktor edhe në Televizionin e Prishtinës, ku bëri edhe disa emisione dokumentare. Që në vitet ’50 përktheu një sërë veprash nga letërsia për fëmijë

(“Njëzet mijë mile nën det”, “Foka e bardhë” etj.) dhe më pas u mor me përkthimin e librave nga fusha e publicistikës politike. (Shaqir Foniqi)

GJEVELEKAJ Gjon (1951-). Kompozitor, mësimdhënës. Lindi në Shëngjergj të Zymit, komuna e Prizrenit. Shkollën e Mesme të Muzikës e kreu në Prizren, studimet në degën e kompozimit në Sarajevë (prof. J. Magdiq), ndërsa specializimin në Paris (prof. J. Casterede). Ndoqi dhe kurset për muzikë bashkëkohore dhe muzikë filmi. Një kohë punoi si mësimdhënës në Shkollën e Muzikës në Prizren (1977-1978), ishte redaktor në Produksionin muzikor të Radio-Prishtinës, më pas mësimdhënës i pianos dhe solfezhit në Shkollën e Muzikës në Shibenik (1992-1994), profesor i kompozimit në Akademinë e Muzikës në Monaco (2000), i formave muzikore në Grasse (Francë, 2002). Ka kompozuar vepra të ndryshme muzikore. Ndër to: këngë për fëmijë, këngë të bazuara në muzikën popullore, këngë solo (“Nëna Terezë”, “Alleluja”, “Rritu vendi im”), kamerale (Imagjinata nr. 10, 11 e 12), orkestrale (Skercio simfonike, Variacione simfonike, Impresione për orkestër harqesh, Simfonia “Albanaise”), koncertale (Koncert për piano e orkestër, Diptihon për piano e orkestër), vokalo-instrumentale (Kantata “Nënës së dëshmorëve të LNÇ”, Meshja “Marris Teresia - Gonxhe Bojaxhiu”), si dhe muzikë filmi (“Rojet e mjegullës”). Ka marrë çmimin e parë të Radiotelevizionit Jugosllav (1984), diplomën e muzikantit akademik në Universitetin e Sarajevës (1981), çmimin “Grand Golden” për muzikë filmi (“Rojet e Mjegullës”, Pulë, 1988) etj. (Kristina Palokaj-Përkola)

GJEVORI Mehmet (1912-2007). Mësues veteran, veprimtar i arsimit. Lindi në Elbasan, ku kreu edhe shkollën plotore gjashtëklasëshe. Më 1933 kreu edhe degën e mësuesisë në kuadër të



MEHMET GJEVORI

Shkollës Teknike Amerikane në Tiranë. Fillimisht ishte mësues në Burrel, përkatësisht në Peqin. Në vitin shkollor 1941/42 filloi punën si mësues, sekretar i Inspektoriatit të Arsimit dhe drejtor i shkollës fillore “Abdyl Frashëri” në Prizren. Më 1944 emërohet anëtar i Këshillit për Arsim dhe Kulturë në Qarkun e Sharrit,

ndërsa në shkurt 1945 u emërua instruktor i arsimit për të gjitha shkollat shqipe në Kosovë, ku punoi deri në vitin 1950. Ishte anëtar i Komisionit Pedagogjik të Drejtoratit të Arsimit të Kosovës. Punoi shumë për organizimin e kurseve pedagogjike, për hapjen e Shkollës Normale në Gjakovë, për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, për luftën kundër analfabetizmit etj. Ishte bashkautor i abetares së parë për të rriturit në Kosovë, botuar më 1946. Ndërkohë, punoi kryeredaktor i revistës “Pionieri”, pastaj edhe në revista të tjera. Në periudhën 1958-1975 punoi në redaksinë e botimeve “Mustafa Bakija”, “Milladin Popoviq”, përkatësisht “Rilindja”, ku ishte redaktor, kryeredaktor, lektor dhe recensent tekstesh shkollore. Ishte gjithashtu autor e bashkautor tekstesh për shkolla fillore dhe profesionale. Përveç arsimit, interes të veçantë tregoi për gjuhën shqipe, për pedagogjinë familjare etj. Për këto fusha shkroi artikuj dhe studime, ndër të cilat edhe veprat: “Frazologjizma të gjuhës shqipe” (1968), “Prindërit dhe fëmijët” (1984), “Prindërit-edukatorë të parë të fëmijëve” (2005), monografinë për shkollën teknike të Tiranës, “Hari Fulc (Harry Fultz) 1921-1933” (2003). Për kontributin e veçantë që ka dhënë në arsimin dhe shkollën shqipe në Kosovë, M. Gjevori u dekorua me Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit I, nga presidenti i Shqipërisë dhe me Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit, nga presidenti i Kosovës. (Afërdita Deva-Zuna)

GJËEGJËZAT. Forma të shkurtra të krijimtarisë gojore, të përbëra nga një pyetje dhe përgjigjja, ku shfaqet përshkrimi metaforik i një objekti të ngjashëm ose të kundërt, duke veçuar disa karakteristika të tij. Gjëegjëzat në Kosovë njihen me emërtimin kashelashë ose “a e din ni sên”. Pjesa e parë përbërëse e gjëegjëzës është pyetja, e cila ka marrë me kohë formën e një formule hyrëse. Format më të shpeshta të pyetjeve janë: “Çështë një?”, “Çështë një gjëegjëzë?”, “Çka është një send?”, “A e din ni sên?” etj. Kjo mënyrë e konceptuar në formë dialogu, me një shprehje të dykuptimshme, e bën atë të jetë shumë dinamike. Si lloje të gjëegjëzave përfshihen edhe enigmat popullore, enigmat problemore, pyetje-përgjegjet etj. Tematikë e gjëegjëzave janë objektet e përditshmërisë së njeriut, si: trupat qiellorë dhe dukuritë natyrore, njeriu, puna dhe mjetet e punës, kultura e banimit,

e ushqimit dhe e veshmbathjes, bota bimore e shtazore etj. Gjëegjëzat kanë një sintaksë relativisht të ndërlikuar, ndërsa figurat stilistike më të shpeshta që ndeshim ndër to janë: metafora, krahasimi, alegoria etj. Shfaqen ose në prozë ose në vargje: një varg i vetëm me rimë në gjysmë dhe në fund të vargut, distik, e shumë rrallë dhe në strofa katërshe apo strofa të lira. Gjatë zhvillimit të saj gjëegjëza ndërroi karakterin dhe funksionin e saj që nga ai i riteve, i bastit e deri te ai i sotmi, që është në funksion të lojës e argëtimit të fëmijëve. Botime të gjëegjëzave janë bërë në Tiranë dhe në Prishtinë. (Leontina Musa)

GJILANI. Qytet dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Është qendër rajonale e Anamoravës së Kosovës, nën administrimin e të cilit janë edhe katër komuna të tjera:



GJILANI

Kamenica, Vitia, Ranillugu dhe Parteshi, me një territor prej 1,331 km². Pozita e volitshme në të dy anët e rrugës Ferizaj-Bujanoc dhe rrafshinat aluviale të lumenjve kanë përcaktuar zhvillimin topografik të qytetit. Shtrihet ndërmjet maleve të Karadakut (Malit të Zi) të Shkupit, maleve të Zhegovcit dhe të zonës së Novobërdës dhe Gollakut. Nëpër qytet rrjedhin përroskat: Dobrusha, Banja dhe Stanishori. Të bashkuara këto degë formojnë lumin e Malishevës, i cili te fshati Uglarë derdhet në Moravën e Binçës. Gjilani hyn në radhën e qyteteve të reja. Për herë të parë përmendet në vitin 1750. Atë e themeloi Beg Gjinolli. Evlia Çelebia këtë qytet e përmend me emrin Morava, ndërsa Ami Boue e përshkruan si lokalitet me 1,500 deri 2,000 banorë. Gjilani në atë kohë ishte një qendër e rëndësishme zejtare. Kështu, në vitin 1897 përmendet si qytet zejtar me 1,000

shtëpi. Zjarri që e kishte përfshirë qytetin në vitin 1830 kishte shkatërruar shumë objekte të vjetra, si Sarajin e Gjinollëve, Kullën e Sahatit, hamamin etj., të cilat ishin dëshmi e jetës qytetare dhe zejtare që zhvillohej në Gjilan. Deri në Luftën e Dytë Botërore Gjilani ishte një qytet relativisht i vogël. Nga objektet kryesore industriale deri në vitet '50 të shekullit të kaluar kishte fabrikën e përpunimit të duhanit dhe kombinatin e tekstilit. Më vonë filloi punën industria e radiatorëve dhe e akumulatorëve. Krahas zhvillimit të industrisë, Gjilani pëson transformime të dukshme në aspektin fizionomik dhe funksional.

Brenda periudhës 1931-1981 numri i popullsisë së Gjilanit u rrit për 4.9 herë. Në vitin 1931 qyteti kishte 7,215 banorë, ndërsa në vitin 1981 kishte 35,249 banorë. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011), Gjilani ka 54,239 banorë. Është vendbanim shumetnik, ku përveç shqiptarëve që përbëjnë shumicën dërrmuese, jetojnë edhe serbët, turqit, boshnjakët, romët etj. Gjilani është qendra më e rëndësishme nodalo-funksionale e Anamoravës dhe një nga shtatë qendrat e mëdha të Kosovës. Ka të zhvilluara funksionet administrative, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe universitare. Arsimimi fillor dhe i mesëm në qytetin e Gjilanit zhvillohet në 9 shkolla fillore, 7 shkolla të mesme, ndërsa ai universitar në katër fakultete: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, që veprojnë në kuadër të Universitetit "Kadri Zeka". Shërbimet shëndetësore ofrohen në spitalin rajonal të Gjilanit dhe në pesë qendra të mjekësisë familjare. Në qytet funksionojnë edhe këto institucione kulturore: Teatri i Qytetit, Biblioteka rajonale "Fan S. Noli", Arkivi Historik dhe Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore. Në Gjilan zhvillohen një sërë aktivitete kulturore të krijuesve profesionistë dhe amatorë të rajonit dhe të Kosovës. (Nexhat H. Rexha)

GJILANI (komuna). Komunë në pjesën juglindore të Kosovës, me qendër qytetin me të njëjtin emër. Në jug dhe juglindje kufizohet me komunën e Likovës (Maqedoni), të Preshevës dhe të Bujanocit (Serbi), në lindje me komunën e Kamenicës, në veri me atë të Novobërdës, në veriperëndim me komunën e Lipjanit, kurse në jugperëndim kufizohet me komunën e Vitisë. Sipërfaqja e territorit të komunës është 392

km², me lartësi mesatare mbidetare rreth 700 m, në të cilën shtrihen 49 vendbanime në 42 zona kadastrale. Deri në vitin 2010 territori i komunës së Gjilanit zinte një sipërfaqe prej 515 km², me gjithsej 63 vendbanime, ndërsa me zbatimin e decentralizimit sipas Pakos së Ahtisarit, sipërfaqja e komunës zvogëlohet për 123 km², për t'u formuar dy komuna të reja, Parteshi dhe Ranillugu. Element kryesor gjeografik i territorit të kësaj komune është lumi Morava, prandaj e tërë kjo hapësirë quhet Anamoravë. Pjesa e ulët e luginës së Moravës e ndan zonën kodrinore-malore të Novobërdës dhe të Gollakut në veri dhe atë të Karadakut të Shkupit në jug. Lugina e Moravës, me lartësi mbidetare 450-500 m, paraqet një rëndësori ndër zonat më atraktive të komunës, ku është përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë dhe e aktiviteteve shoqërore-ekonomike. Lugina e Moravës ka mundësuar lidhje të mira me pjesët e ndryshme të Kosovës dhe jashtë saj. Nëpërmjet kësaj luginë komuna e Gjilanit lidhet me pjesën lindore të Kosovës dhe del në korridorin e Moravës Jugore dhe të Vardarit. Në drejtim të perëndimit lidhet me Fushën e Kosovës dhe autostradën Prishtinë-Durrës. Në zonën e ulët të fushës së Moravës mbizotërojnë sedimentet e reja. Sedimentet liqenore të neogjenit kanë një shtrirje të madhe, duke filluar nga Gjilani në perëndim, për të vazhduar edhe më tej në territorin e komunës së Kamenicës në lindje. Rreth lumit Morava janë të pranishme konglomeratet, zhavorri dhe rëra e pleistocenit, ndërsa në zonat kodrinore-malore dominojnë shkëmbinjtë e moshës parakembriane. Klima e komunës së Gjilanit dallon në një masë të konsiderueshme nga ajo e Prishtinës dhe e Ferizajt. Temperatura mesatare e janarit me -0.9^o C është relativisht më e lartë se ajo e dy komunave të tjera, që kanë temperaturën mesatare të janarit -1.4^o C, ndërsa temperatura mesatare e korrikut është 20.7^o C. Sasia e vogël e reshjeve me 583 mm në vit është edhe një veçori tjetër e kësaj komune, kurse sasia më e madhe bie në muajin nëntor. Lumi kryesor në komunën e Gjilanit është Morava e Binçës, degë e majtë e Moravës Jugore. Morava rrjedh nëpër fushën e Gjilanit me gjatësi prej 24 km. Karakterizohet me shtrat të gjerë e të cekët dhe meandrat të shumta, me mundësi të daljes nga shtrati, duke shkaktuar shpeshherë vërshime të mëdha. Maksimumi i prurjes është në muajin mars, ndërsa minimumi është shënuar në

muajin gusht, që është 12 herë më i vogël se maksimumi. Në lumin e Livoçit është ndërtuar liqeni artificial me funksion antieroziv.

Rritja e numrit të popullsisë në komunën e Gjilanit ishte mjaft dinamike. Pas Luftës së Dytë Botërore (1948-2011) numri i popullsisë së komunës është dyfishuar. Në vitin 1948 komuna e Gjilanit kishte 43,863 banorë, ndaj 90,178 banorëve në vitin 2011. Rritja e numrit të popullsisë reflektohet edhe në rritjen e dendësisë së banimit. Derisa në vitin 1948 në komunën e Gjilanit kanë jetuar 81.4 b/km², në vitin 2011 në të jetojnë 230 b/km². Veprimtaritë kryesore ekonomike janë: bujqësia dhe blegtoaria, pylltaria, tregtia, zejtaria, ndërtimtaria dhe hoteleria. Nga degët e industrisë janë të zhvilluara industria ekstraktive (guroret), industria ushqimore, ajo e tekstilit etj. Shërbimet shëndetësore në komunë realizohen përmes spitalit rajonal dhe gjashtë qendrave të mjekësisë familjare. Spitali rajonal, me disa reparte specialistike, ofron shërbime edhe për popullsinë e komunave të tjera përreth, si dhe për komunën e Preshevës dhe të Bujanocit. Teatri profesionist i qytetit, biblioteka kryesore me 10 njësi nëpër fshatra, arkivi historik, qendra rajonale e trashëgimisë kulturore, fushat sportive etj., i japin Gjilanit atributet e një qendre të rëndësishme rajonale të Anamoravës. (Nexhat H. Rexha)

GJILANI Sali (-1912). Luftëtar i lëvizjes kombëtare. Lindi në Gjilan. Ishte bashkëluftëtar i Idriz Seferit dhe mori pjesë në kryengritjen e vitit 1910. Më pas u dënua me burg, së bashku me djemtë e tij. Mori pjesë në zgjedhjet osmane të vitit 1912 si kandidat i opozitës, së bashku me Hamdi Novobërdën dhe u votuan më së shumti në kazanë e Gjilanit, si kandidat për parlamentin e Vilajetit të Kosovës. Mori pjesë aktive në Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912 dhe për shkak të aktivitetit kundërosman, Fadil Pasha, komandant i ushtrisë osmane, urdhëroi djegien e pasurisë dhe internimin e familjes së tij. Më 26 korrik 1912 mori pjesë në sulmin për çlirimin e Gjilanit. Pas dështimit të bisedimeve shqiptare-osmane në Prishtinë, në krye të 5,000 kryengritësve, mori pjesë në Kuvendin e Ferizajt, ndërsa u vu në krye të 2,000 luftëtarëve që çliruan Shkupin. Pas kthimit nga Shkupi, në fund të shtatorit të vitit 1912 largoi kajmekamin e kazasë së Gjilanit dhe vendosi pushtetin vendor në krye me Idriz

Seferin. Për të mbrojtur kufirin e Kosovës nga sulmet serbe, në tetor të vitit 1912, në krye të 3,000 kryengritësve vendoset në Ristovc. Vritet në Lapërdincë të Bujanocit nga shpërthimi i një gjyleje topi. (Naim Musliu)

GJIMNAZET. Shkolla të mesme të përgjithshme, të cilat janë hapur në Kosovë qysh në vitin 1913 (në gjuhën serbe). Në vitin 1941 hapen dy gjimnaze me mësim në gjuhën shqipe në Kosovë: në Prishtinë dhe në Prizren. Nga viti shkollor 1944/45 në Kosovë rihapen rreth dhjetë gjimnaze të ulëta dhe filloi themelimi i gjimnazeve të larta. Deri në vitin 1958, gjimnazi kishte dy nivele: gjimnazi i ulët (kl. I-IV) dhe gjimnazi i lartë (kl. V-VIII). Me reformën e vitit 1958, gjimnazi i ulët i bashkëngjitet shkollës fillore, e cila bëhet tetëvjeçare, ndërsa gjimnazi i plotë (gjimnazi real) me mësim katërvjeçar pavarësohet. Gjimnazi real kishte dy drejtime: natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor. Deri në vitet '70 të shek. XX, nxënësit deklaroheshin për njërin prej këtyre drejtimeve, pas kryerjes së klasës së parë, e cila ishte e përgjithshme. Gjimnazet, si dhe shkollat e tjera, ishin të ndarë në baza gjuhësore (gjimnazi shqiptar, gjimnazi serb), ndërsa nga viti shkollor 1955/56 ata integrohen në një kolektiv punues, me një drejtor, por me mësim të ndarë sipas gjuhës. Me reformën e arsimit të mesëm të vitit 1977, gjimnazet pushojnë së vepruari, reduktohen kryesisht në shkolla të bazave të përbashkëta të arsimit të mesëm të orientuar (kl. I e II). Si vazhdimësi e gjimnazeve në arsimin e mesëm të orientuar (kl. IV e V) vepronin degët natyrore-teknike dhe matematikore-teknike. Me reformën e arsimit të mesëm të vitit 1987, gjimnazet përsëri shndërrohen në shkolla të mesme katërvjeçare, me degët: natyrore-matematikore dhe kulturologjike-gjuhësore. Në vitin 1990 bëhet një reformë e re, përmes së cilës në gjimnaze rikthehen degët dhe drejtimet sipas lëmenjve të punës. Gjimnazet u profilizuan në pesë drejtime: gjimnazi i përgjithshëm, gjimnazi dydrejtëmësh: natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor, gjimnazi filologjik (gjuhësor), gjimnazi matematikor dhe gjimnazi arsimor (pedagogjik). Gjatë viteve në vijim ky profilizim do të pësojë ndryshime, për të arritur kështu te dy tipa gjimnazesh: gjimnazi i shkencave natyrore dhe gjimnazi i shkencave shoqërore. Prej vitit

shkollor 2003/04, mësimi në gjimnaze zgjat tri vjet. Gjimnazi konsiderohet shkollë e arsimit të mesëm të lartë. Veprojnë, kryesisht, si shkolla të veçanta. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI "LOYOLA", PRIZREN. Gjimnaz klasik me seli në Prizren, që u legalizua nga shteti në vitin shkollor 2005/06. Nisma për hapjen e këtij institucioni arsimor u ndërmor që në vitin 2002. Gjimnazi u themelua me bashkëpunimin trepalësh ndërmjet Ministrisë së Arsimit të Kosovës, të Komunës së Prizrenit dhe të asociacionit "Loyola-Gymnasium" nga Gjermania. "Loyola-Gymnasium" është asociacion jofitimprurës me interes të përgjithshëm. Prizreni është përzgjedhur si lokacion i këtij gjimnazi, duke qenë një qytet me peshë historike dhe me pozitë të rëndësishme gjeografike në këtë rajon. Ky institucion arsimor udhëhiqet nga koncepti i punës i bazuar në pedagogjinë injaciane. Gjimnazi "Loyola" i Prizrenit ka arritur të bëhet anëtar i rrjetit evropian të shkollave jezuite, si dhe shkollë partnere me shkolla të Republikës Federale të Gjermanisë. Procesi i mësimdhënies në këtë shkollë zhvillohet në gjuhën amtare, ndërsa mësohet latinishtja, gjermanishtja dhe gjuha angleze. Gjimnazi ka dy konvikte, njërin për vjaza dhe tjetrin për djem. Testet e arritshmërisë të viteve të fundit, të organizuara nga Ministria e Arsimit, kanë dëshmuar se gjimnazi zhvillon aktivitetet të suksesshëm arsimor. (Ndue Ukaj)

GJIMNAZI FILOLOGJIK, PRISHTINË. Gjimnazi filologjik "Eqrem Çabej" në Prishtinë u themelua në vitin 1990. Pararendëse e tij ishte shkolla e mesme kulturologjike dhe e informimit publik, me tri degë. Në vitin 1979 formohet si qendër e arsimit të mesëm të orientuar (QAMO) për veprimtari kulturologjike, e cila përfshinte edhe gjimnazin matematikor dhe atë filologjik. Gjimnazi filologjik vazhdon veprimtarinë dhe ka këto drejtime: gjuhë e letërsi shqipe, gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane dhe gjuhë latine. Nxënësit që diplomojnë në këtë shkollë janë kandidatë potencialë për studimin e gjuhëve dhe të degëve të kulturës dhe të informimit. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I DEÇANIT. Gjimnazi i Deçanit, që tani mban emrin "Vëllezërit Frashëri", u themelua në vitin 1967. Ishte shkollë e mesme me mësim katërvjeçar. Pararendëse e tij ishin dy paralele të gjimnazit të Pejës (drejtimi

pedagogjik), që u hapën në Deçan në vitin 1962. Deri në vitin shkollor 1976/77 gjimnazi kishte dy drejtime: shkencor dhe shoqëror, ndërsa nga ajo kohë deri në vitin shkollor 1988/89 ishte qendër e arsimit të mesëm të orientuar me 12 drejtime. Në vitin shkollor 2003/04, kjo shkollë shndërrohet në gjimnaz të përgjithshëm me këto drejtime: të përgjithshëm, të shkencave natyrore, të shkencave shoqërore dhe drejtimi i shkencave gjuhësore.

GJIMNAZI I DRAGASHIT. Gjimnazi "Emin Duraku" (tani "Ruzhdi Berisha") në Dragash u themelua në vitin 1969. Nisi punën në lokalet e shkollës fillore, kurse në vitin shkollor 1972/73 kaloi në ndërtesën e re, ku punon edhe tani. Gjenerata e parë e nxënësve të këtij gjimnazi nisi me dy paralele, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe. Në vitin shkollor 1978/79, sipas reformave arsimore, gjimnazi u shndërrua qendër të arsimit të mesëm të orientuar (QAMO). Në fazën e parë nxënësit merrnin njohuri të përgjithshme, kurse në fazën e dytë orientoheshin në degët tekstil, biologji-kimi dhe kulturologji, ndërsa nga viti shkollor 1987/88 në degët e bujqësisë, veterinarisë, ekonomike-komerciale, matematike-natyrore, të tregtisë dhe të tekstilit. Nga viti shkollor 1991/92 gjimnazi vazhdoi punën pa nxënës dhe arsimtarë shqiptarë, vetëm me paralelet gorane, ndërsa nxënësit shqiptarë e vazhduan procesin mësimor jashtë objektit të tyre shkollor. Pas përfundimit të luftës, që nga viti shkollor 1999/2000 gjimnazi i Dragashit e vazhdoi punën me planprogramet e Ministrisë së Arsimit të Kosovës. (Esat Krasniqi)

GJIMNAZI I DRENASIT. Gjimnazi "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Drenas, si shkollë e mesme e pavarur, u themelua në vitin 1970. Pararendëse të saj ishin paralelet e ndara të gjimnazit "Ivo Lolla Ribar" të Prishtinës, të cilat nisën punën në Drenas në vitin shkollor 1967/68. Në vitin shkollor 1971/72 në kuadër të gjimnazit hapen edhe paralelet e klasës së parë të Qendrës shkollore "Nikolla Teslla" të Obiliqit. Në vitin 1993 kjo shkollë profilizohet, ndahet në dy shkolla të veçanta: gjimnazi dhe shkolla e mesme teknike, të cilat veprojnë si shkollë e mesme e përgjithshme dhe si shkollë e mesme profesionale. (Naser Zabeli)

GJIMNAZI I FERIZAJT. Gjimnazi i Ferizajt, që mban emrin "Kuvendi i Arbërit", u themelua

në vitin shkollor 1967/68. Ishte shkollë me mësim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Fillimisht ishte gjimnaz real, ndërsa në vitin shkollor 1975/76 u shndërrua në qendër të arsimit të mesëm: në vitin e parë dhe të dytë arsim i përgjithshëm, ndërsa në vitin e tretë dhe të katërt arsim i orientuar. Dhjetë vjet më vonë gjimnazi u kthye sërish në gjendjen e mëparshme. Për shkak të administratës së dhunshme serbe, periudha prej vitit 1990-1999 ishte kohë e mbijetesës. Në vitin shkollor 2010/11, kjo shkollë, përveç drejtimit shkencor-natyror, u profilizua edhe me dy drejtime të tjera: gjuhësor dhe shkencor-shoqëror. (Nijazi Zylfiu)

GJIMNAZI I FUSHË-KOSOVËS. Gjimnazi “Hivzi Sylejmani” në Fushë-Kosovë u themelua në vitin 1982, fillet e të cilit nisin me paralelet e ndara të gjimnazit të Prishtinës “Ivo Lloja Ribar”. Ishte objekt i reformës sipas arsimit të mesëm të orientuar, me profile të ndryshme. Në vitin shkollor 1990/91 u shndërrua në gjimnaz të përgjithshëm. Në vitin 2004 shkollat e mesme në komunën e Fushë-Kosovës (gjimnazi, shkolla ekonomike dhe ajo teknike) u integruan me emërtim të përbashkët: shkolla e mesme “Hivzi Sylejmani”, me tri drejtime: gjimnazi, ekonomia dhe teknika. Gjimnazi ka dy profile: natyror dhe shoqëror. (Vlora Sylaj)

GJIMNAZI I GOSTIVARIT. Shkollë e mesme komunale në Gostivar. Mësimi në gjuhën shqipe në këtë shkollë filloi në vitin shkollor 1960/61. Deri në vitin shkollor 1985/86 numri i nxënësve rritej vazhdimisht. Në periudhën kohore 1986-1991 u formuan “paralelet e përziera”, me nxënës maqedonas, shqiptarë dhe turq, ku mësimi mbahej vetëm në gjuhën maqedonase. Gjuha shqipe ishte vetëm si lëndë mësimore. Nga viti shkollor 1994/95 gjimnazi i Gostivarit ka dy drejtime: matematikor dhe gjuhësor, me mësim në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe turqisht. (Avzi Mustafa)

GJIMNAZI I GJAKOVËS. Gjimnazi real “Hajdar Dushi” në Gjakovë u themelua në vitin 1953. Në vitin shkollor 1944/45 në Gjakovë u hap gjimnazi i ulët. Gjimnazi i Gjakovës ishte me mësim në gjuhën shqipe. U mbyll përkohësisht dhe u rihap në vitin shkollor 1957/58. Nga viti 1961 në kuadër të kësaj shkolle vepronte edhe shkolla e tekstit. Në vitin shkollor

1977/78 gjimnazi shndërrohet në qendër të mësimit të mesëm të orientuar, faza e parë e bazave të përbashkëta. Si shkollë e mesme e përgjithshme kishte këto degë: natyrore-teknike, matematike-teknike dhe shëndetësore. Në vitin 1990 shndërrohet në gjimnaz me degët matematike-natyrore dhe shoqërore-gjuhësore. Tani është shkollë e mesme e lartë me këto profile të përgjithshme: shkenca natyrore, shkenca shoqërore-gjuhësore dhe matematikë-informatikë. (Valentina Nimonaj-Hoti)

GJIMNAZI I GJILANIT. Gjimnazi “Zenel Hajdini” në Gjiilan u themelua në vitin 1945. Fillimisht ishte gjimnaz i ulët, i përgjithshëm, me paralele të përziera (serbe e shqiptare). Hapi paralele edhe në Kamenicë, Viti e Bujanoc. Me reformën e arsimit të mesëm, gjimnazi kishte drejtime të ndryshme: shkencor-natyror, shoqëror, ekonomik, tregtar, të drejtësisë, të mjekësisë, pedagogjik etj. Në vitet '90 të shek. XX, për shkak të administratës së dhunshme serbe, u detyrua ta zhvillojë veprimtarinë në shtëpi-shkolla. Në vitin shkollor 2013/14 gjimnazi filloi të punojë me kurikulën e re të Kosovës. Është me dy drejtime themelore: natyror dhe shoqëror, ndërsa në klasën XI e XII programi profilizohet në pesë drejtime. (Januz Dervodeli)

GJIMNAZI I ISTOGUT. Gjimnazi i Istogut, tani “Haxhi Zeka”, u themelua në vitin 1964. Ishte shkollë e mesme me mësim katërvjeçar. Pararendëse të tij ishin tri paralele të gjimnazit të Pejës, hapur në vitin 1962: dy me mësim në gjuhën shqipe dhe një me mësim në gjuhën serbokroate. Prej vitit 1976 deri në vitin shkollor 1988/89 funksionoi si qendër e arsimit të mesëm të orientuar, me dy nivele dhe kishte 7 drejtime. Nga viti 2000, gjimnazi u profilizua në tri drejtime: shkencat natyrore, shkencat shoqërore dhe drejtimi matematikë-informatikë. Në këtë shkollë kanë diplomuar 51 gjenerata nxënësish nga Rrafshi i Dukagjinit dhe më gjerë. (Demë Mulliqi)

GJIMNAZI I JUNIKUT. Gjimnazi “Kuvendi i Junikut” në Junik, u pavarësua në vitin 2008. Pararendëse e tij ishin paralelet e ndara të Qendrës së Mesme të Mësimit të Orientuar (QAMO) të Deçanit. Fillimisht kishte katër drejtime: shkencat natyrore, shkencat shoqërore, matematikë-informatikë

dhe drejtimi i përgjithshëm. Me zbatimin e kurikulës së re të Kosovës, gjimnazi i Junikut ka dy drejtime: shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore. (Demë Hoti)

GJIMNAZI I KAÇANIKUT. Gjimnazi “Skënderbeu” në Kaçanik u themelua në vitin 1967, me mësim vetëm në gjuhën shqipe Në kuadër të tij, në vitin shkollor 1972/73 vepronin edhe dy degë të shkollës teknike. Në vitin shkollor 1973/74 u shndërrua në qendër shkollore. Gjatë viteve 1977-1987, pas fazës së parë të bazave të përbashkëta (kl. I dhe II), në kl. III dhe IV vepronte si shkollë e mesme profesionale, me degë dhe profesione: elektroteknikë, xehetari, ndërtimtari, kimi-teknologji dhe bujqësi. Në vitin 1987 i shtohen edhe degët matematikore-teknike dhe natyrore-teknike. Prej vitit shkollor 1991/92 deri në vitin shkollor 1996/97, veprimtaria arsimore u organizua në shtëpi-shkolla. Gjatë viteve '90 gjimnazi kishte paralele të ndara në Han të Elezit, në Bob dhe në Kaçanikun e Vjetër. Gjimnazi u pavarësua nga shkolla e mesme profesionale në vitin shkollor 2002/03 dhe ka tri drejtime: shkencat natyrore, shkencat shoqërore dhe i përgjithshëm. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I KAMENICËS. Shkollë e mesme e themeluar në vitin shkollor 1966/67, mbi bazën e paraleleve të gjimnazit të Gjilanit, të hapura një vit më parë. Ka paralele të ndara në Hogosht (1970) dhe në Roganë (1991). Ishte me mësim në gjuhën shqipe dhe serbe. Gjimnazi fillimisht kishte drejtimin shoqëror-gjuhësor dhe drejtimin natyror-matematikor. Në vitin shkollor 1974/75 gjimnazi integrohet në shkollën teknike të Gjilanit me dy degë: makineri dhe kimi-teknologji. U shndërrua në qendër të arsimit të mesëm të orientuar me dhjetë degë dhe me disa profesione. Me reformën e vitit 1987 shkolla kishte pesë degë. Në vitin shkollor 1993/94 gjimnazi ndahet nga shkolla e mesme profesionale. Në vitet '90 të shek XX, kjo shkollë, për shkak të rrethanave politike e zhvilloi veprimtarinë në shtëpi-shkolla. Prej vitit shkollor 2014/15 vepron si shkollë pilot, me drejtimet e shkencave natyrore dhe të shkencave shoqërore. (Januz Dervodeli)

GJIMNAZI I KËRÇOVËS. Gjimnazi “Mirko Maleski” në Kërçovë u hap në vitin shkollor 1956/57, me mësim në gjuhën maqedone.

Mësimi në gjuhën shqipe së pari filloi në vitin shkollor 1964/65, por u ndërpre, për të filluar rishtas një vit më vonë. Përsëri mësimi shqip u ndërpre, për të rifilluar në vitin shkollor 1970/71, duke vazhduar me shumë vështirësi. Në vitin 1991 paralelet me mësim në gjuhën shqipe u shkëputën nga gjimnazi i Kërçovës, por sërish u kthyen në kuadër të tij. Shkolla e mesme komunale “Mirko Maleski” në Kërçovë, me mësim në dy gjuhë vazhdoi deri në vitin 2010, kur u themelua shkolla e mesme komunale “Drita” me këto drejtime: gjimnaz, makineri, shëndetësi, elektroteknikë dhe ekonomi. (Fadbi Osmani)

GJIMNAZI I KLINËS. U themelua në vitin shkollor 1969/70, ndërsa si paralele e ndarë e gjimnazit të Pejës filloi një vit më parë. Me pavarësimin e gjimnazit të Klinës, filloi punën edhe paralelja e tij në Kijevë. Prej vitit 1978 kjo shkollë vepron si qendër e arsimit të mesëm të orientuar. Përveç bazave të përbashkëta të arsimit, kjo qendër shkollore në vitet 1977-1987 kishte këto degë të arsimit të orientuar: makineri, xehetari, kimike-teknologjike, bujqësi, veterinari, hotelieriturizëm, ekonomike-komerciale, matematike-teknike, natyrore-teknike. Me reformën e vitit 1987, numri i degëve u reduktua në: makineri, xehetari-geologji, bujqësi, juridik dhe natyror-matematikor, me profesionet përkatëse. Në vitin 1990 gjimnazi kishte dy drejtime: makineri dhe bujqësi. Në rrethana të jashtëzakonshme të krijuara nga autoritetet serbe, gjatë viteve '90 gjimnazi e zhvilloi veprimtarinë e tij në shkolla fillore dhe në shtëpi private. Deri në vitin shkollor 2014/15, gjimnazi kishte drejtimin e përgjithshëm dhe atë matematikë-informatikë. Po në këtë kohë ai vepron si shkollë pilot, në drejtimet: shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore-gjuhësore. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I KUMANOVËS. Gjimnazi “Goce Delçev” në Kumanovë u themelua në vitin shkollor 1944/45, me mësim në gjuhën maqedone. Fillimisht ishte gjimnaz klasik, ndërsa më pas u profilizua në matematikor dhe të përgjithshëm. Në vitin shkollor 1964/65 në këtë shkollë hapet edhe paralelja e parë me mësim në gjuhën shqipe. Mësimin shqip në këtë shkollë e shoqëruan vështirësi, sidomos politike. Për pasojë, në vitin shkollor 1988/89 u mbyllën të gjitha paralelet shqipe në shkollat

e mesme të Kumanovës, por ato vazhduan të punonin në formë jashtinstitucionale. Pas vitit 2001, paralelet shqipe u ndanë nga ato maqedonase, në objekte të veçanta. Në vitin shkollor 2010/11 u themelua gjimnazi i ri “Sami Frashëri” në këtë qytet, ku u përfshinë paralelet shqipe. Gjimnazi ka këto drejtime: matematikor-natyror, shoqëror-humanitar dhe gjuhësor-artistik. (Minir Ademi)

GJIMNAZI I MALISHEVËS. Gjimnazi “17 Nëntori” i Malishevës u themelua në vitin 1987. Prej vitit shkollor 1971/72 deri në vitin 1987 në Malishevë vepronte paralelja e ndarë e gjimnazit të Rahovecit. Nga viti 1990 gjimnazi kishte dy drejtime: natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor, kurse në vitin shkollor 1996/97 hapet edhe drejtimi pedagogjik, si dhe dy paralele të ndara të shkollës së mesme të mjekësisë të Gjakovës. Për shkak të administratës së dhunshme serbe në vitin shkollor 1991/92, nxënësit dhe mësimmësuesit e kësaj shkolle u detyruan ta braktisin objektin e tyre dhe ta vazhdojnë veprimtarinë arsimore në lokale private dhe në objekte të shkollave fillore. Kthimi në objektin e mëparshëm u bë në vitin 1999. Gjimnazi i Malishevës, “Hamdi Berisha” ka drejtime: shkencat natyrore, shkencat shoqërore dhe drejtimin matematikë-informatikë. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I MITROVICËS. Ishte shkolla e parë e mesme shqipe në këtë qytet. Fillet e tij i ka te progjimnazi (1946), përkatësisht gjimnazi i lartë shqiptar (1951) në Mitrovicë. Në vitin 1955 gjimnazi shqiptar u integrua me gjimnazin shtetëror serb, u quajt gjimnaz i përzier dhe u pagëzua me emrin “Silvira Tomazini”. Deri në vitin shkollor 1976/77, gjimnazi kishte dy drejtime: të shkencave shoqërore dhe të shkencave natyrore. Me aplikimin e të ashtuquajturit arsim i mesëm i orientuar u bënë ndryshime edhe në këtë shkollë, me disa degë në fazën e dytë. Në vitet 1991-1999, gjimnazi e zhvilloi veprimtarinë e vet në shtëpi-shkolla. Deri në vitin 2004 kjo shkollë ka pasur dy profile: shoqëror dhe natyror. Së fundi ka pesë profile: të përgjithshëm, matematikë-informatikë, shkençor, shoqëror dhe të gjuhëve. (Afërdita Kumnova-Mulla)

GJIMNAZI I PEJËS. Gjimnazi i Pejës (sot me emrin “Bedri Pejani”) u themelua në vitin

1946, si gjimnaz real shtetëror shqiptar dhe gjimnaz real shtetëror serb. Pararendës të tij ishin idadija turke (1908), gjimnazi malazez (1913), ai jugosllav (1919) dhe dega liceale shqiptare (1941). Në vitin 1955 gjimnazi i Pejës filloi punën si shkollë e mesme katër klasash, me mësim në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Në vitin shkollor 1959/60 kishte drejtimet shoqëror, natyror dhe atë pedagogjik. Me reformën e vitit shkollor 1977/78, gjimnazi ndahet në dy faza dhe në drejtimet: kulturologji, biologji, shëndetësi, kimi-teknologji dhe matematikor-teknik, për të vazhduar kështu deri në vitin shkollor 1987/88, kur bashkohet faza e parë me të dytën. Për shkak të administratës së dhunshme serbe, prej vitit 1991-1999, mësimin në gjuhën shqipe në këtë gjimnaz u zhvillua në shtëpi-shkolla. Nga vitit 1999 gjimnazi “Bedri Pejani” në Pejë zhvillon mësimin në gjuhën shqipe dhe boshnjake. (Izet Musaj)

GJIMNAZI I PODUJEVËS. Gjimnazi i Podujevës, që mban emrin “Aleksandër Xhuvani”, u themelua në vitin shkollor 1962/63. Ishte shkollë e mesme me mësim katërvjeçar, tani trevjeçar. Pararendëse e tij ishin paralelet e gjimnazit “Ivo Lllolla Ribar” të Prishtinës, të themeluara në Podujevë në vitin 1961. Nxënësit e kësaj shkolle janë kryesisht nga rajoni i Llapit. Shumica e mësimmësuesve fillimisht vinin nga gjimnazi i Prishtinës. Brezi i fundit i gjimnazistëve në këtë shkollë u diplomua në vitin 1980. Gjimnazi i Podujevës u rihap në vitin 1991. Për shkak të dhunës së administratës serbe, veprimtarinë e vet deri në vitin 1999 e zhvilloi në shtëpi-shkolla. Nga ky gjimnaz kanë dalë emra të njohur të shkencës dhe të kulturës. (Ismet Potera)

GJIMNAZI I PRESHEVËS. U themelua në vitin shkollor 1964/65. Pararendës të tij ishin paralelet e para të gjimnazit të Vranjës, që u hapën në Preshevë në vitin shkollor 1961/62. Në vitin shkollor 1968/69 gjimnazi i Preshevës mori emrin “Skënderbeu” dhe hapi paralelet e tij në Tërnoc, të cilat më vonë u bartën në Bujanoc, ku themelohet shkolla e pavarur. Në vitin shkollor 1974/75 gjimnazi transferohet në qendër të arsimit të mesëm të orientuar (QAMO), me disa drejtime dhe profile. Në vitin 1989 në këtë institucion vendosen masat e dhunshme, me ç’rast autoritetet serbe ndërmorën një fushatë



GJIMNAZI I PRESHEVËS

antishqiptare, duke përjashtuar mësimdhënësit shqiptarë, duke ndryshuar plan-programet mësimore etj. Në vitin shkollor 1990/91 nga kjo qendër shkollore themelohen dy shkolla të mesme: shkolla e mesme teknike me disa drejtime dhe profile dhe gjimnazi me dy drejtime, të shkencave shoqërore dhe të shkencave natyrore. (Gafur Hyseni)

GJIMNAZI I PRISHTINËS. Gjimnazi “Sami Frashëri” (fillimisht “Ivo Lolla Ribar”) në Prishtinë u themelua në vitin shkollor 1944/45. Aso kohe u themeluan dy gjimnaze



GJIMNAZI “SAMI FRASHËRI”, PRISHTINË

të larta në Prishtinë: Gjimnazi Real Shtetëror Shqiptar dhe Gjimnazi Real Shtetëror Serb. Ishin gjimnazet e para të plota në Kosovë. Në kuadër të tyre fillimisht vepronin edhe shkolla të tjera. Në Gjimnazin Real Shtetëror Shqiptar nxënësit ishin nga treva të ndryshme të Kosovës. Gjenerata e parë e tyre u diplomua në vitin 1949. Në vitin shkollor 1955/56 bëhet bashkimi i këtyre dy gjimnazeve në një shkollë të vetme. Në vitet 1978-1987 në gjimnazin e Prishtinës organizohej arsimiti i përgjithshëm i

mesëm i orientuar, kurse në vitet 1987-1990 ka vepruar si shkollë e mesme profesionale me disa profesione. Prej vitit shkollor 1990/91 vepron si gjimnaz në drejtimet: natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor. Po në këtë vit shkollor 1991/92, nxënësit dhe mësimdhënësit shqiptarë të kësaj shkolle u larguan me dhunë nga objektet e tyre dhe e vijuan punën mësimore në shtëpi-shkolla. Në objektet shkollore u kthyen në vjeshtë të vitit 1999. Mësimi në këtë gjimnaz zhvillohet në gjuhën shqipe dhe, për nxënësit e komunitetit turk, në gjuhën turke. Gjimnazi ka drejtimet e shkencave natyrore-matematikore, të shkencave shoqërore-gjuhësore dhe të përgjithshëm. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I PRIZRENIT. Mban emrin “Gjon Buzuku” dhe është shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm. Është vazhdimësi e një tradite të gjatë të arsimit të mesëm në Prizren, që filloi me ruzhdien turke (1874), vazhdoi me shkolla të mesme serbe, për të arritur te Liceu “Gjon Buzuku” me mësim në gjuhën shqipe (1941-1944). Pas Luftës së Dytë Botërore, gjimnazi mbante emrin “Jovanka Radivojeviq-Kica”, e zhvilloi punën mësimore në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke. Në vitet 1991-1999, mësimi shqip u zhvillua në shtëpi-shkolla. Kjo shkollë e mesme e lartë ka dy drejtime: matematikor-natyror dhe shoqëror-gjuhësor. Paralele të ndara ka edhe në Romajë, Gjonaj dhe Reçan. (Riza Brada)

GJIMNAZI I RAHOVECIT. Gjimnazi “Ramiz Sadiku” i Rahovecit u themelua më 1961, fillimisht me mësim në gjuhën serbokroate, ndërsa prej vitit shkollor 1965/66 me mësim edhe në gjuhën shqipe. Si paralele e ndarë e gjimnazit të Prizrenit punoi qysh në vitin shkollor 1957/58. Gjimnazi ishte shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm. Në vitin 1977 shndërrohet në qendër të arsimit të mesëm. Në periudhën 1978-1987 kjo shkollë kishte dy faza të arsimit të mesëm të orientuar. Në fazën e dytë profesionale kishte profesione të degëve të teknikës, bujqësisë, ekonomisë, natyrore-teknike dhe matematikore-teknike. Në vitin 1990 në këtë shkollë rikthehen drejtimet e gjimnazit natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor, si dhe lëmenjtë e punës: bujqësia dhe përpunimi i ushqimit, makineria dhe përpunimi i metaleve dhe kimi-teknologji. Prej vitit shkollor 1991/92

deri në vitin 1999, veprimtarinë vet, për shkak të masave të dhunshme serbe, u detyrua ta zhvillonte në shtëpi-shkolla dhe në objekte të shkollave fillore. Deri në vitin shkollor 2013/14 ishte shkollë e përzier, gjimnaz dhe shkollë profesionale, ndërsa prej vitit shkollor 2014/15 gjimnazi ka dy drejtime: shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I STRUGËS. Gjimnazi “Vëllezërit Milladinov” në Strugë u hap në vitin shkollor 1960/61, me mësim në gjuhën shqipe dhe maqedone. Në vitin 1979 gjimnazi u bashkua në një organizatë, e cila u quajt Qendra e Arsimit të Mesëm “Niko Nestor” me këto drejtime: gjimnaz, ndërtimtari, gjeodezi, ekonomitekstili, kimi-teknologji. Në vitin 2006 kjo qendër shkollore u nda në dy shkolla të mesme të pavarura: gjimnazi “Dr. Ibrahim Temo” dhe shkolla e mesme “Niko Nestor”. Në gjimnazin “Dr. Ibrahim Temo” mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke, ndërsa në shkollën e mesme komunale “Niko Nestor”, në drejtimet tri dhe katërvjeçare: ndërtimtari, gjeodezi, kimi-teknologji, kozmetikë, ekonomi-juridik, mjekësi, hotelieri etj. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe maqedonase. (Fadbi Osmani)

GJIMNAZI I SUHAREKËS. Gjimnazi “Jeta e re” i Suharekës, si shkollë e mesme e përgjithshme, u themelua më 1970. Në vitin shkollor 1967/68 në Suharekë u themelua paralelja e gjimnazit të Prizrenit. Në vitin 1972 gjimnazi u shndërrua në qendër të arsimit të mesëm, e cila kishte gjimnazin, shkollën teknike dhe shkollën ekonomike. Me arsimin e mesëm të orientuar, ky institucion, me mësim në gjuhën shqipe dhe serbokroate, kishte degët: makineri, elektroteknikë, ndërtimtari, kimi-teknologji, tekstil, gomë, bujqësi, veterinari, tregti, juridik, ekonomike-komerciale, matematike-teknike, natyrore-teknike. Me reformën e vitit shkollor 1987/88, numri i degëve në këtë shkollë u zvogëluar. Mbeten degët: makineri, elektroteknikë, kimike-teknologjike, ushqimore dhe natyrore-matematikore. Në vitin 1990 kjo shkollë hapi paralelet e ndara në Bukosh dhe Mushtisht. Në vitin shkollor 1995/96 nga gjimnazi ndahet shkolla teknike. Tani gjimnazi i Suharekës ka drejtimet natyror-matematikor dhe shoqëror-gjuhësor. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I SHKUPIT. Shkollë e mesme e qytetit të Shkupit, e cila u themelua në vitin 1972, mbi bazat e shkollës normale shqipe “Zef Lush Marku” po në këtë qytet. Deri në vitin shkollor 1977/78 gjimnazi kishte dy drejtime: drejtimin e përgjithshëm dhe drejtimin pedagogjik. Në vitin 1979 do t'i shtohet edhe drejtimi tregtar. Në vitin shkollor 1983/84, krahas paraleleve për mësim në gjuhën shqipe, u hapën edhe paralelet në gjuhën maqedonase. Reforma e tij do të vazhdojë, për të arritur kështu të drejtimet: matematikor, gjuhësor dhe të mjekësisë. Gëzon reputacionin e shkollës së suksesshme në Republikën e Maqedonisë. (Avzi Mustafa)

GJIMNAZI I TETOVËS. Shkollë e mesme komunale në Tetovë, fillet e së cilës nisin në vitin 1941. Në vitin shkollor 1945/46 vazhdoi punën si gjimnaz katër klasash. Deri në vitin 1982 kishte këto drejtime arsimore: drejtimi i përgjithshëm, matematikor-natyror, gjuhësor dhe pedagogjik. Sipas reformës së arsimit të mesëm të orientuar, nga viti shkollor 1982/83-1991/92, në këtë shkollë vepronin edhe drejtimet matematikë-informatikë, xehtar-metalurgjik dhe kimik-teknologjik. Nga viti shkollor 1992/93 kjo shkollë e arsimit të mesëm të orientuar shndërrohet përsëri në gjimnaz, i cili pati ngritje të vazhdueshme, duke përfshirë numrin e nxënësve dhe kualifikimin e mësimdhënësve. Në këtë gjimnaz arsimohen kryesisht nxënës nga Tetova, Gostivari, Kërçova etj. (Avzi Mustafa)

GJIMNAZI I TUZIT. Shkollë e mesme, e themeluar në Tuz më 1975. Pararendëse të tij ishin dy paralele të ndara fizike të gjimnazit të Podgoricës, që filluan në Tuz në vitin shkollor 1971/72. Këto paralele u themeluan për nxënësit shqiptarë të trevave të Malësisë së Madhe. Në vitin 1975 u formuan edhe paralelet me mësim edhe në gjuhën serbokroate. Numri i nxënësve u rrit vazhdimisht, për të arritur kulmin në vitin shkollor 1980/81. Kjo shkollë u reformua dhe quhet shkolla e mesme “25 Maji” në Tuz. (Palokë Berisha)

GJIMNAZI I ULQINIT. Gjimnazi “Vëllazërim-bashkim” në Ulqin u themelua në vitin 1965, me mësim në gjuhën shqipe dhe në atë serbokroate. Kjo shkollë më vonë u reformua dhe quhet shkolla e mesme e kombinuar



GJIMNAZI I ULQINIT

“Vëllazërin-bashkim”, ku arsimohen kuadro për nëntë profile arsimore, prej të cilave dy profile arsimore të shkallës së katërt profesionale: gjimnazi i përgjithshëm dhe teknik i turizmit dhe shtatë profile arsimore të shkallës së tretë profesionale: kamarier, gjellëbërës, shitës, elektromekanik i makinave dhe i pajisjeve, automekanik etj. Në këtë institucion arsimohen nxënës nga Ulqini, Ana e Malit, Kraja, Tuzi etj. Është institucioni më i rëndësishëm i arsimit të mesëm shqip në Mal të Zi. Shquhet edhe për veprimtari kulturore-artistike. (Ali Llundj)

GJIMNAZI I VITISË. Gjimnazi i Vitisë, si shkollë e mesme e përgjithshme, u themelua në vitin 1970. Në vitin shkollor 1968/69 në Viti u themelua paralelja e ndarë e gjimnazit të Gjilanit, me mësim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate. Me zbatimin e reformës së mësimin të mesëm të orientuar, në vitin shkollor 1976/77, Gjimnazi i Vitisë shndërrohet në qendër arsimore, me paralele të ndara në Pozharan, Verbovc dhe Goshicë. Në vitin shkollor 1982/83, në kuadër të kësaj qendre arsimore, nxënësit kishin mundësi të arsimoheshin në profesione të ndryshme të katëyre degëve: bujqësi, makineri, elektroteknikë, degën matematike-teknike, degën natyrore-teknike, ndërtimtari, degën kimike-teknologjike, juridike, ekonomike-komerciale, gjeologjike, tregti, hotelieri, xehetari dhe shëndetësi (teknik fizioterapeut). Në vitin shkollor 1990/91 numri i degëve u reduktua. Për shkak të administratës së dhunshme serbe, prej vitit 1991-1999, shkolla e zhvilloi veprimtarinë e vet në objekte të shkollave fillore, në objekte fetare dhe në shtëpi private. Në vitin 2002 gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” u nda nga shkolla e mesme profesionale dhe ka pesë drejtime: i përgjithshëm,

i gjuhëve, i shkencave natyrore, i shkencave shoqërore dhe drejtimin matematikor-informativ. Prej vitit shkollor 2014/15, ky gjimnaz vepron si shkollë pilot me drejtimin natyror dhe shoqëror. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI I VUSHTRISË. Shkollë e mesme me mësim katërvjeçar (tani trevjeçar), e cila u pavarësua në vitin shkollor 1972/73. Katër paralelet e para të gjimnazit filluan nga puna në vitin shkollor 1963/64 në kuadër të shkollës ekonomike “Moshë Pijade” në Vushtrri. Me reformën e vitit shkollor 1976/77, kjo shkollë u shndërrua në qendër të arsimit të mesëm të orientuar. Nga viti 1990-1999, kur në gjimnaz u vunë masat e dhunshme administrative serbe, nxënësit shqiptarë u detyruan ta vijonin mësimin në shtëpi-shkolla. Shumë nxënës të kësaj shkolle u shquan edhe si studentë dhe profesionistë në fusha të ndryshme. (Fahri Buçinca)

GJIMNAZI MATEMATIKOR, PRISHTINË.

Gjimnazi “Xhevdet Doda” në Prishtinë u themelua në vitin 1971. Ishte shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm, me mësim në gjuhën



GJIMNAZI “XHEVDET DODA” NË PRISHTINË

shqipe dhe serbokroate. Me sistemin e arsimit të mesëm të orientuar, gjimnazi u shndërrua në shkollë të bazave të përbashkëta të arsimit. Prej vitit shkollor 1990/91 ky gjimnaz ka drejtimin natyror-matematikor. Në vitin shkollor 1991/92, për shkak të masave të jashtëzakonshme serbe, kjo shkollë e zhvilloi veprimtarinë e saj në shtëpi-shkolla. Deri në vitin 2010 pati vështirësi për sigurimin e një objekti të përshtatshëm shkollor. Tani, në objekt të ri, vepron si gjimnaz me drejtimin e shkencave natyrore. (Bajram Shatri)

GJIMNAZI NË SKËNDERAJ. Gjimnazi “Hamëz Jashari” (më parë “Ramiz Sadiku”) në Skënderaj, si shkollë e veçantë u themelua në vitin shkollor 1967/68, me mësim në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Pararendëse të tij ishin dy paralele të Normales së Mitrovicës, që u hapën në Skënderaj në vitin shkollor 1967/68. Në vitin shkollor 1980/81 gjimnazi shndërrohet në qendër të arsimit të mesëm të orientuar, me degët: natyrore-matematikore, bujqësore, ekonomike-juridike, makineri dhe përpunim i metaleve, arsimor-pedagogjik, biologji-kimi dhe dy paralele të shkollës së mesme të mjekësisë të Mitrovicës. Së fundi në gjimnazin e Skënderajt vepron katër degë: e përgjithshme, shkencor-natyor, matematikë-informatikë dhe shoqëror-gjuhësor. (Xhafer Ismajli)

GJINAJ Bedri (1913-1945). Mësues, gazetar. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore e mbaroi në Mitrovicë, ndërkaq Shkollën Teknikë Amerikane “Harri Fulc” në Tiranë. Për afro



BEDRI GJINAJ

dhjetë vjet punoi mësues dhe edukator në konviktin dhe shkollën fillore të Burrelit, në Shqipëri. Pas vitit 1941 dha kontribut të veçantë për hapjen e shkollave shqipe në rajonin e Mitrovicës dhe të Novipazarit. Krahas shtrirjes së arsimit shqip u shqua për organizimin e të rinjve në qytetin e Mitrovicës në veprimtari kulturore dhe humanitare. U angazhua për mbrojtjen e popullsisë shqiptare dhe boshnjake nga sulmet e çetnikëve që vinin nga Serbia. Organizoi publikime dhe drejtoi punën e transmetimeve radiofonike në Prishtinë në vitin 1943, që kishin filluar nga nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri”. Në vitin 1943 mori pjesë në Kuvendin Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe u zgjodh sekretar i saj. Në vjeshtë të vitit 1944 formoi Batalionin e Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës, i cili vepronte në kuadër të organizatës “Lëvizja Popullore Shqiptare”, ndërsa nga fundi i vitit 1944 u rreshtua në Brigadën e Drenicës të Shaban Polluzhës dhe ishte anëtar i shtabit. Në maj të vitit 1945 u arrestua dhe u vra nga OZN-a në rrethana të panjohura. U dekorua me Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit I nga Presidenti i Shqipërisë. (Ibrahim Berisha)

GJINALI-KABASHI Sevime (1937). Kompozitore, pianiste, mësimdhënëse, profesoreshë universiteti. Lindi në Prizren. I përket brezit të parë që kreu Shkollën e Ulët, përkatësisht



SEVIME
GJINALI-KABASHI

të Mesme të Muzikës në Prizren. Më pas kreu Akademinë e Muzikës në Beograd, drejtimi teorik-pedagogjik. Karrierën e mësimdhënësës e filloi në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren. Nga viti 1961 punoi redaktore në programin muzikor të Radio-Prishtinës dhe vazhdoi punën e mësimdhënësës së solfezhit në Shkollën e Mesme të Muzikës dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Ka qenë drejtore e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe drejtore e produksionit muzikor të Radiotelevizionit të Prishtinës. Pas themelimit të Akademisë së Arteve, u zgjodh pedagoge e lëndës solfezh në degën e artit muzikor (1975) dhe udhëheq këtë njësi universitare. Njëherësh vazhdon të jetë aktive si kompozitore e pjesëve për piano (“Miniatura”, “Elegji”, “Duart e arta”, “Koncert i vogël”), e këngëve solo/romanca për zë e piano (“Kjo anë e Bistricës”, “Ma fal atë gërshetë”, “Kur të perëndon dielli”, “Lulet në mars”, “Për ty liri”, “Mirë se erdhe dallëndyshe”, “Dita e parë”, etj.), këngëve për pionierë (“Pranvera”, “Vera”, “Vjeshta”, “Dimri”, “Zoti Tralalani”, “Kënga e zogut”, “Nënës”, etj.), këngëve në frymën popullore (“Kënga e Prishtinës”, “Lules”, “Martja”, “Të fala nënës”, “Do të mbjell një mollë”), këngëve korale (“Skënderbeu”, “Atdheut”, “Vendlindja ime”, “Për vend e vatër”, “Për ty liri...”) potpuri vallesh (“Vallja e burrave”, “Vallja e vajzave”, “Vallja e rëndë...”). Mjaft syresh janë realizuar dhe incizuar në produksionin muzikor në Televizionin e Prishtinës. Është bashkautore e dy teksteve (me prof. Seniha Spahiun) dhe autore e tekstit universitar “Solfezhi”. Është anëtare e Shoqatës së Kompozitorëve e Kosovës dhe e shpërblyer me çmime të shumta, ndër to dhe Çmimin për veperë jetësore “Niketë Dardani”. (Zeqirja Ballata)

GJINI Dom Gaspër (1930-1985). Prift dhe studiues. Lindi në Ferizaj, ku kreu shkollën fillore, ndërsa seminarin e vogël e përfundoi në Shkodër, për të vazhduar teologjinë në Gjakovë të Sllavonisë (Kroaci). U shugurua meshtar në

vitin 1955. Pas disa vjetësh të shërbimit baritor u dërgua në studime pasuniversitare në Romë, ku u doktorua në vitin 1968. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Shkup, ku shërbeu si famullitar. Në vitin 1962, së bashku me dom Nikollë Minin filloi botimin e fletushkës ipeshkvnore “Zani i Zojës Cërnağore”. Po ashtu, për nevoja fetare përpiloi librin e uratave “Shujta shpirtërore”, që u ribotua disa herë. La të shkruar veprën studimore “Ipushkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj”, e cila u botua së pari kroatisht (1986) dhe më pas në shqip (1992), si dhe anglisht (2002). Libri është një pasqyrë sistematike që përfshin periudhat kryesore të zhvillimit të krishterimit në hapësirat që ndërlidheshin me Ipushkinë Shkup-Prizren gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës. (Ndue Ukaj)

GJINI Gjergj (1942-2011). Hendbollist. Lindi në Prishtinë. Së pari ishte i angazhuar në futboll e basketboll, e më vonë si hendbollist. Si hendbollist ishte i angazhuar në skuadrën “Borci” të Ferizajt, ku luajti deri në vitin 1972. Ishte njëri nga themeluesit e kësaj skuadre, e cila më vonë arriti rezultate të mira në gara vendore dhe ndërkombëtare. Ishte edhe udhëheqës i Shoqatës së Gjyqtarëve të Hendbollit të Kosovës dhe konsiderohej njëri ndër njohësit më të mirë të rregullave të lojës së hendbollit në ish-Jugosllavi. Më vonë u zgjodh edhe kryetar i Lidhjes së Hendbollit të Jugosllavisë. (Albatri Matoshi)

GJINI Vinçenc (1935-). Kompozitor, profesor. Lindi në Ferizaj. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren. U diplomua në drejtimin teoriko-pedagogjik në Akademinë e Muzikës në Beograd (1958), ku kreu edhe studimet pasuniversitare për harmoni e kontrapunkt (1961). Më pas përfundoi studimet e kompozimit në Shkollën e Lartë të Muzikës në Shkup. Ishte



VINÇENC GJINI

producent në Radio-Prishtinë dhe pedagog i harmonisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1963-1975). Me hapjen e degës së muzikës të Akademisë së Arteve (1975), do të jetë profesor deri në pensionim (1991). Ka një opus të gjerë veprash të formave e gjinive muzikore, nga këngët e përpunuara popullore

e deri te veprat simfonike. Veçohen kantatat: “Vatra e urtësisë” (1980), “Të duam liri” (1981), “Baladë në gur” (1981), “Udhëkryqet e jetës” (1985), “Dallëndyshja mirandjellëse” (1998); pastaj këngë korale: “Blegëron delja” (1971), “Vajta në Elbasan” (1971), “Hijet” (1972), si dhe të veprave orkestrale: Simfonieta in D, 4 simfonitë e kompozuar në vitet 1979-85 dhe Vallja orkestrale (1980) e Suita (1980). Janë të rëndësishme dhe veprat sakrale: dy vëllime këngësh me 119 dhe 193 këngë dhe një botim me 25 këngë. Është hartues i librit universitar “Harmonia” (1984). Nga viti 1992 jeton në Buje të Kroacisë. (Reze Kryeziu-Breznica)

GJINOCI. Fshat në komunën e Suharekës, 4.5 km në jug të qytetit, shtrihet në anën lindore të rrugës Prizren-Suharekë. Është vendbanim fushor, kryesisht i tipit të grumbulluar. Njihet si vendbanim i hershëm, me gjurmë nga periudha antike. Mes dy luftërave botërore këtu u vendosën kolonë serbë (41 familje), të cilët u shpërngulën pas Luftës së Dytë Botërore. Në regjistrimin e vitit 1948 kishte 638 banorë, kurse në regjistrimin e vitit 2011, në vendbanim ishin të pranishëm 2,221 banorë. Gjatë luftës së fundit 90% e fshatit u dogj nga forcat serbe, përfshirë edhe objektet e infrastrukturës. Për një kohë të gjatë kishte rolin e bashkësisë lokale, ndërsa më vonë vendbanimet e kësaj zone gravitojnë në Suharekë. Pjesa më e madhe e popullsisë merret me bujqësi. Ka shkollë 9-vjeçare, qendër të mjekësisë familjare, njësi tregtie etj. (Valbon Bytyçi)

GJINOLLI Abdurrahman Pashë (shek. XIX-XX). Kryetar i degës së Prishtinës të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa bijtë e tij, Zija Beu dhe Alidanish Beu, që morën mbiemrin Prishtina, ishin anëtarë aktivë të Komitetit të Stambollit dhe veprimtarë të Lidhjes. Dega e Prishtinës e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nën drejtimin e A. Pashës, u përkujdes për mbrojtjen e kufirit me Serbinë dhe bëri përpjekje që muhaxhirët e dëbuar nga sanxhaku i Nishit të ktheheshin në vendbanimet e tyre. Në prill të vitit 1879 në sanxhakun e Prishtinës u formua një komision i veçantë për vendosjen, sistemimin dhe përkujdesjen e muhaxhirëve. A. Pasha më 1896 ndërtoi shkollën ruzhdije (progjimnaz) në Prishtinë, ku vijonin mësimet 136 nxënës, numër ky që në vitin 1900/01 arriti në 230 nxënës. Kjo shkollë më vonë u bë spital i mushkërive në Prishtinë. Familja

Gjinolli themeloi koleksionin e parë muzeor në Kosovë, i formuar nga fundi i shek. XVIII dhe i shkatërruar në vitin 1912, që shënoi edhe fundin e pushtetit të familjes Gjinolli. (Aliriza Selmani)

GJINOLLI Enver (1938-). Mësimdhënës universitar. Lindi në Gjiilan. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, kurse Fakultetin e Edukatës Fizike në Beograd. Studimet



ENVER GJINOLLI

pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Zagrebit, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës. Në moshë të re u mor me voleyboll, futboll dhe not. Pas përfundimit të fakultetit, punoi në Shkollën Normale “Skënderbeu” në Gjiilan (1963-1970), ku formoi klubin e parë të voleybollit “Partizani”, tash KV “Drita”. Nga viti 1964-1969 e drejtoi KH “Bozhuri”. Punën e trajnerit të futbollit e filloi në Beograd, e vazhdoi në KF “Cërvena Zvezda” të Gjiilanit, kurse në vitet 1973-1980 ishte shef i shtabit teknik në KF “Slloga” të Shkupit. Në vitin shkollor 1980/81 u zgjodh ligjërues në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë. U angazhua në Federatën e Voleybollit dhe në Federatën e Futbollit të Kosovës. Merret me publikime profesionale dhe shkencore nga fusha e kulturës fizike. (Lulzim Shala)

GJINOLLI Ilir (1962-). Inxhinier i arkitekturës, mësimdhënës universitar. Lindi në Gjiilan, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, kurse studimet në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (1986). U zgjodh asistent (1988) dhe më pas ligjërues në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës për lëndën dizajni urban. Ishte njëri prej themeluesve dhe drejtues i Institutit për Planifikim Hapësinor në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (2002). Udhëhoqi hartimin e versionit të parë të planit hapësinor për Kosovën (2006). Në vitin 2010, së bashku me arkitektin spanjoll Alfredo Navarro, themelojnë konkursin urbanistik arkitektonik “European” në Kosovë. Në periudhën 2003-2006 vazhdoi specializimin profesional në Roterdam, Holandë.

Nga veprimtaria profesionale duhet veçuar hartimi i këtyre projekteve: Plani Hapësinor i Kosovës (2006), Biblioteka Rajonale në Gjakovë, projekti i fisibilitetit të Kompleksit Qeveritar në Prishtinë etj. Ka marrë pjesë me kumtesa në disa konferencat ndërkombëtare. (Flamur Doli).

GJINOLLI Jashar Pashë (?-1840). Njëri nga qeveritarët e njohur të familjes feudale Gjinolli, me ndikim të veçantë në zhvillimet politike të fillimit të shek. XIX në Kosovë. Jashar Pasha ishte i biri i Mehmet Pashës, vëllait të Maliq Pashës. Ai trashëgoi qeverisjen në Prishtinë dhe në pjesën më të madhe të Kosovës. J. Pasha me pashallarët e tjerë shqiptarë, u bënë rezistencë reformave të Sulltan Mahmutit II. Mori pjesë në luftë kundër Vezirit të Madh, Mehmet Reshid pashës, në anën e Mustafë Pashë Bushatliut. Pas disfatës së Mustafë Pashës në Babunë dhe dorëzimit të tij në tetor të vitit 1831, shumë pashallarë shqiptarë, në mesin e tyre edhe Jashar Pasha, për t'i ruajtur privilegjet, hoqën dorë nga luftimet dhe i kërkuan falje Portës së Lartë. Duke u vënë në shërbim të Portës, patën rol të rëndësishëm në shuarjen e kryengritjes boshnjake-shqiptare. Pas Betejës në Pale, në maj të vitit 1832 dhe shuarjes së kryengritjes së Hysein Gradashcit, ku pos sanxhakbeut të Prizrenit, Mahmut Pashë Rrotullajt, morën pjesë edhe Gjinollët me forcat e tyre. Këta të fundit ruajtën pushtetin e tyre në Kosovë, kurse Jashar Pasha dhe Maliq Pasha mbetën persona të pacenueshëm. Pjesëmarrja në kryengritjen e Mustafë Pashë Bushatliut dhe përpjekjet për t'u shkëputur nga sundimi osman zemëruan Portën e Lartë. J. Pasha humbi jetën në vitin 1840, në rrethana të panjohura. Kishte synim zhvillimin dhe modernizimin e vendit. Ndërtoi disa objekte të infrastrukturës në Prishtinë. (Aliriza Selmani)

GJINOLLI Maliq Pashë (shek. XIX). Njëri ndër qeveritarët e njohur të familjes feudale Gjinolli, i cili në fillimi të shekullit XIX ishte sanxhakbe i Shkupit. Në kuadër të këtij sanxhaku ishin tri kadillëqe: i Prishtinës, i Vushtrrisë dhe i Novobërdës. Nga kjo familje u shquan sidomos Maliq Pasha dhe Jashar Pasha. Në kohën e tyre, Gjinollët zotëronin rreth 16,000 hektarë tokë në Fushën e Kosovës, në Anamoravë, Vrajë dhe vende të tjera. Kriza e Perandorisë dhe problemet në Shqipëri, bënë që Maliq Pasha dhe bashkëmendimtari i tij,

Mahmut Pashë Rrotulla, mytesarif i Prizrenit, të kishin përkrahjen e sulltanit në qeverisje. Maliq Pasha krijoi një ushtri të rregullt prej 8,000 këmbësorësh dhe 2,000 kalorësish, me të cilën mori pjesë në shuarjen e Kryengritjes së Parë (1804) dhe të Dytë Serbe (1815), si dhe ndihmën që i dha Osman Pashës, më 1809, për ta shpëtuar nga rrethimi i serbëve te Novi Pazari. Për luftërat e suksesshme të tij janë thurur edhe këngë popullore. Kriza e Perandorisë Osmane dhe dobësimi i pushtetit qendror, bëri që sulltani të lejonte administrimin e pushtetarëve lokalë në disa vende, në mesin e tyre edhe të Gjinollëve. Këtë situatë e shfrytëzuan Maliq Pasha dhe Jashar Pasha, të cilët bashkëpunuan edhe me Ali Pashë Tepelenën dhe me pashallarët e Shkodrës, me qëllim që vilajetet shqiptare të siguronin një autonomi më të madhe. (Aliriza Selmani)

GJIRAKU-GLLAVICA Vezire (1922-). Veterane e arsimit, atdhetare, bashkëshortja e Adem Gllavicës. Lindi në Sllatinë të Madhe. Në vitin 1924 bashkë me familjen u shpërngul në Shqipëri. Pas vdekjes së të atit, Kryqi i Kuq Shqiptar e sistemoi në Strehën Vorfno, ku ndoqi shkollën fillore dhe pastaj vijoi Institutin Femëror “Nëna Mbretëreshë”. Në vitin 1943 kthehet në Kosovë dhe emërohet mësuese në shkollën fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Në maj të vitit 1943 mori pjesë në demonstratat e të rinjve kundër okupuesit fashist. Në fund të Luftës së Dytë Botërore i bashkohet njësiteve të rezistencës kombëtare. Një kohë, së bashku me të shoqin, qëndron në malet e Plitkovicës. Pasi ishte shtatzënë kthehet në fshatin Gllavicë, ku qëndron e fshehur. Në fund të vitit 1945 kërkon të largohet për në Shqipëri, por në Ferizaj burgoset së bashku me foshnjën. Pas lirimit nga burgu, në mungesë të arsimtarëve në Kosovë, caktohet mësuese në shkollën fillore “Bajram Curri” në Prizren. Në verën e vitit 1946 ekstradohet në Shqipëri. Ishte mësuese në Shullaz, Milot dhe në Krujë. Në tetor të vitit 1947 arrestohet në Krujë me akuzën për “veprimtari armiqësor”. Pas një viti, në mungesë provash, lirohet. Vazhdon punën si mësuese në Tiranë. Punon deri në vitin 1972, kur pensionohet. Është bartëse e Urdhrit “Naim Frashëri” të klasit I dhe i mirënjohjeve të tjera. Jeton në Tiranë. (Sulltane Ukaj)

GJOCAJ Ilir (1974-). Dramaturg, skenarist, regjisor, producent. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje,

studimet për dramaturgji në Fakultetin e Arteve, ndërkaj ato për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Është autor i disa dramave, si: “Bodrumi” (2009), “Kuzhina e viktimave” (2009) dhe i libretos “Arieta” (2012). Dramat e tij janë inskenuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe në Teatrin “Dodona”. Si dramaturg punoi në Teatrin Shqiptar të Shkupit dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Është skenarist dhe regjisor i filmit të shkurtër “Denis Profeti” (2003), me të cilin fitoi çmimin e filmit më të mirë në Festivalin e Filmit 9/11. Është gjithashtu bashkëskenarist dhe bashkëregjisor i komedisë televizive “Tezga alternative” (2003), regjisor i dokumentarëve “Violinat ‘Kurta’” (2001), “Pse unë?” (2002) dhe “Parnassus paper” (2012). Bëri edhe regjinë e shfaqjes “Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq” (2015). (Doruntina Basha)

GJOCAJ Shefqet (1962-). Dramaturg, arkitekt. Lindi në Kovragë të Istogut. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Istog. Ndoqi studimet për arkitekturë në Fakultetin Teknik dhe për dramaturgji në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punoi si gazetar në të përditshmen “Koha ditore” (1997-2002) dhe më herët reporter i TVSH-së (1994-1997). Ka shkruar skenarë për filma të metrazhit të shkurtër dhe metrazhit të gjatë. Ka bërë skenarin e filmit “Kthimi”, në regjinë e Blerta Zeqirit, të është shpërblyer për skenar në Festivalin “9/11” në Prishtinë dhe i cili më pas mori çmimin kryesor në Festivalin e Filmit në Sandancë, në SHBA, në vitin 2012. Më pas ishte drejtor i Ansambllit “Shota” në Prishtinë. (Selman Jusufi)

GJOCAJ Zenun (1943-2013). Gjuhëtar. Lindi në fshatin Gjocaj. Shkollën fillore e kreu në Junik, ndërsa të mesmen në Pejë, Shkollën e Lartë pedagogjike në Prizren, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë. Po në Prishtinë u magjistrua dhe më pas u doktorua (2007) në fushën e gjuhësisë. Punoi në shkollën të ndryshme të Kosovës, pastaj në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës dhe më vonë në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Më 1981 u burgos për veprimtari ilegale. Në Vushtrri pas vitit 1999 punoi si këshilltar pedagogjik dhe drejtor i drejtorisë komunale të arsimit. Ka botuar artikuj për gjuhën si dhe veprat “Gjuha e Luigj Gurakuqit dhe konceptet e tij gjuhësore e stilistike” dhe “Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe”. Ka shkruar artikuj

për dëshmorët e UÇK-së, është bashkautor dhe bashkëbotues i veprës në disa vëllime “Feniksët e lirisë – Dëshmorët e UÇK-së”. Ka botuar dhe poezi. Më 2014, pas vdekjes, u botua vëllimi “Vështrime letrare”. Është bashkautor i monografisë për Vushtrrinë. (Rexhep Ismajli)

GJOKAJ Gjekë (1941-1997). Mësimdhënës dhe veprimtar i arsimit. Lindi në Milesh të Tuzit në Mal të Zi. Shkollën fillore e kreu në Tuz, normalen në Pejë dhe studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Fillimisht punoi si mësues në shkollën fillore të Tuzit, pastaj mësimdhënës në shkollën e mesme po në Tuz. Në periudhën 1981-1995 punoi në Entin Republikan për Përparimin e Shkollave në Mal të Zi. Ishte autor i disa teksteve për shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Mal të Zi. Punoi edhe në Ministrinë e Arsimit të Malit të Zi. (Palokë Berisha)

GJOKAJ Gjelosh (1933-2016). Pikturor, grafist. Lindi në Milesh të Tuzit, në Mal të Zi. Shkollën e Mesme të Artit dhe Akademinë e Arteve Figurative i kreu në Beograd (1963). Që nga hapja



GJELOSH GJOKAJ

e degës së artit figurativ në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe deri më 1968 ishte profesor i vizatimit dhe i grafikës. Në periudhën 1968-1983 jetoi dhe veprroi në Romë. Pas kësaj periudhe u largua nga Italia dhe u vendos në Gjermani. Opusi krijues i Gj. Gjokajt ndahet në disa cikle, si në fushë të grafikës, ashtu dhe në pikturë: “simbolizmi sintetik” (grafikat e fazës së parë), “metafizik” (robotët, kokat, torzotë), pastaj ciklet e pikturave “Ditari nga Roma”, “Zogjtë” e deri te pikturat abstrakte dëshmojnë se fjala është për një krijues të veçantë. Veprat e realizuara në frymën e introduktit metafizik më së miri shpërfaqin identitetin e tij krijues. Në disa kompozime shfaqet figura pa kokë, që mban në prehër një fëmijë të pajetë, të gjymtuar, në prapvijën e të cilëve një mori zogjsh të gurëzuar sikur shprehin egërsinë e kësaj skene metafizike. Hapi shumë ekspozitat personale, duke filluar nga vitet '60, si në Sombor, Beograd, Prishtinë, Novi-Sad, Milano etj., gjatë viteve '70 në Romë (1970, 1973, 1976 etj.), pastaj në Porto S. Giorgio, L'Aquila etj. Më pas, gjatë viteve '80 ekspozoi

në Podgoricë, në Budvë, në Sveti-Stefan, në Zagreb, në Prishtinë, ndërsa pas vitit 2000 në Holandë, Itali, Mal të Zi, Gjermani, Shqipëri etj. Mori pjesë në shumë ekspozita kolektive në Kosovë, Mal të Zi dhe në qendrat e ndryshme europiane dhe botërore. Është fitues i shumë mirënjohjeve dhe i çmimeve publike, institucionale dhe profesionale, duke filluar nga viti 1966: Shpërblimi i Dhjetorit i KSA të Kosovës, Shpërblimi i Nëntorit i komunës së Prishtinës, çmimi i parë “Miqte e artit Linjano” në Itali, Shpërblimi republikan i Malit të Zi “13 Korriku”, çmimi i parë për format të vogël Galeria “Ecke” në Augsburg të Gjermanisë, çmimi “Herman Gotz Marktoberdorf” dhe çmimi për grafikë në Zenden po në Gjermani, çmimi për vepër jetësore në Mal të Zi etj. Ishte anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Vdiq në Augsburg të Gjermanisë. (Hivzi Muharremi)

GJOKAJ Mikel (1946-). Pikturor, grafist. Lindi në Krushevë të Madhe të komunës së Klinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Pejë. Kreu Akademinë e Arteve



MIKEL GJOKAJ

Figurative në Beograd (1974). Një vit më vonë u vendos në Romë të Italisë, ku vijoi të merret intensivisht me krijimtari artistike. Arti i tij ngjalli interesim në qarqet kulturore të Italisë dhe më gjerë. Mori pjesë në disa manifestime të arteve pamore në Itali, Francë, Luksemburg, Poloni, Japoni, Tajvan etj. Hapi disa ekspozita personale në Romë dhe në qytete të tjera të Italisë. Ekspozita tematike “Toka e qielli”, e hapur në Kompleksin Muzeor Vittoriano të Romës më 2010 ka dëshmuar para auditorit një artist antologjik të kohës. Peizazhet magjepsëse të tij me ngjyra të harmonishme e kontraste, me vija poetike dhe tonalitete kanë jetësuar mallin për tokën dhe qiellin e vendlindjes. Aktualisht jeton në Romë dhe merret me pikturë dhe grafikë. (Rexhep Goçi)

GJOKIQ Ruzhica (Ružica Đokić) (1935-). Aktore. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje. Në Teatrin Popullor Krahinor, në ansamblin e dramës serbe, u pranua si aktore në vitin 1951. Në këtë teatër luajti në këto shfaqje: “Pop Qira

dhe pop Spira”, “Spiunët”, “E shoqja e Hasan Agës”, “Mica dhe Mikica”, “I ndjeri”, “Tartufi”, “Foshnja ime”, “Të gjithë djemtë e mi”, “Gjaku i papastër”, “Orkestra e grave”, “Tri motrat”, “Violina magjike”, “Zgjimi i vampirit”, “Zona a Zamfirit”, “Procesi”, “Kësulëkuqja” etj. U nderua me çmime dhe mirënjohje për punën në teatër. (Bekim Lumi)

GJONBALAJ Hasan (1935-2012). Mbledhës i folklorit dhe traditës, poet. Lindi në Vuthaj (Mal të Zi), ku edhe i mori mësimet e para. Kreu Normalen në Gjakovë, ndërsa studioi për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Për shumë vjet punoi si mësimdhënës, fillimisht në vendlindje e pastaj në Pejë. Pas rifillimit të punës të Institutit Albanologjik të Prishtinës (1968) u zgjodh bashkëpunëtor i jashtëm në degën e folklorit dhe të etnografisë. Botoi libra me poezi për fëmijë dhe për të rritur dhe disa monografi (“Këngët historike në Krahinën e Plavës dhe Gucisë”, “Lufta e Nokshiqit-epope kundër copëtimit të trojeve shqiptare”, “Ali Pashë Gucia”, “Rite dhe zakone” etj.). Dha kontribut të çmuar në mbledhjen e folklorit, të dokeve, të zakoneve dhe të traditës të krahinës së Plavës dhe të Gucisë. Mori pjesë në sesione dhe simpoziume shkencore vendore dhe ndërkombëtare. (Bashkim Lajçi)

GJONBALAJ Malsor (1978-). Futbollist, trajner. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Përfundoi Fakultetin e Shkencave Sportive në Universitetin e Prishtinës. Po në këtë fakultet kreu studimet e magjistraturës dhe tani është mësimdhënës. Është trajner i licencuar nga Federata e Futbollit e Maqedonisë, Licenca B e UEFA-s. Po ashtu ka licencë për trajner edhe nga Federata Suedeze e Futbollit. Si futbollist, Gjonbalaj ka luajtur për KF “Besa” të Pejës, për Prishtinën, për “Trepçën ’89” të Mitrovicës, për “Apoloninë” e Fierit, për “Flamurtarin” e Prishtinës etj. Ka të fituar dy tituj kampioni, një kupë dhe dy superkupa. (Leutrim Mustafa)

GJONBALAJ Mujë (1956-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Vuthaj, komuna e Plavës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë (1975), ndërsa Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1979. Studimet pasuniversitare i kreu në



MUJË GJONBALAJ

këtë universitet (1984) dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti gjithashtu në UP (1995). Në vitin 1997 u zgjodh docent në Fakultetin e Bujqësisë dhe më vonë profesor i rregullt për lëndët statistikë, statistikë aplikative, biometri me statistikë dhe evoluim i projekteve. Si autor apo bashkautor publikoi një numër punimesh shkencore, projekte dhe elaborate në fushën e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Është pjesëmarrës me kumtesa në tubime shkencore në vend dhe në botën e jashtme. Është autor i disa monografive studimore (“Strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës, faktori njerëzor si një potencial i zhvillimit ekonomik”, “Faktori i ndikimit ekonomik dhe demografik në zhvillimin demografik në Kosovë” etj.). (Ragip Kastrati)

GJONBALAJ Rifat (1965-). Gazetar i sportit. Lindi në Vuthaj, Mal të Zi. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Pejë, ndërkaq studimet në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi si mësimdhënës në Pejë. Në moshë të re u mor më futboll dhe luajti në klubet: “Buduqnosti”, “Besa” dhe “Flamurtari”. Ishte pjesë e përfaqësueses së të rinjve të Kosovës. Pas përfundimit të karrierës si futbollist nisi të merrej me gazetari sportive, duke u bërë korrespondent i sportit në medime të ndryshme (RTV21, Radio-Kosova, “Zëri”, “Kosova sport” etj.). (Baki Berisha)

GJONI Daut (1946-). Mjek gjinekolog obstetër. Lindi në Katërkoll të Ulqinit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Cetinë (Mali i Zi). U regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, më pas kaloi në Zagreb, ku u diplomua në vitin 1971. Pas studimeve u kthye në vendlindje, ku punoi si mjek i përgjithshëm. Në vitin 1974 emigroi në SHBA dhe më 1975 filloi punë në Institutin e Patologjisë në Nju-Xhersi. Më vonë vazhdoi specializimin për gjinekologji, u transferua në Gloversville, ku krahas punës në spitalin “Nathan Littauer”, hapi edhe klinikën e vet private. U zhvendos në Albany, ku punoi në Klinikën Qendrore dhe kishte klinikën e tij private. Është anëtar

i shumë shoqatave e institucioneve shkencore mjekësore në Amerikë. Ishte themelues dhe përkrahës i fondacionit për shkollimin e talentëve shqiptarë në SHBA dhe ka organizuar ndihma për Kosovën. Punon në "Hedrick Centre" në Chillicothe, Missouri. Ka botuar një varg punimesh shkencore dhe profesionale në Amerikë, në Kanada dhe në vende të tjera të botës. (Isuf Dedushaj)

GJONI Zef (1937-2015). Mjek, pediatër, profesor universiteti. Lindi në Ferizaj, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në Shkup. U diplomua në Fakultetin



ZEF GJONI

e Mjekësisë në Shkup (1962). Pas diplomimit u emërua mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Ferizaj. Kaloi në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë, më vonë në Klinikën e Pediatrisë të Fakultetit të Mjekësisë, ku u emërua asistent i lëndës së pediatrisë. Mbaroi specializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1978). Një kohë ishte kryeshefi i repartit të kardiologjisë në Klinikën e Fëmijëve në Prishtinë. Gjatë periudhës 1989-1990 ishte prodekan për arsim në FMP. U përjashtua nga puna në vitin 1990 dhe u angazhua në organizimin e Fakultetit të Mjekësisë jashtë hapësirave institucionale. Ishte profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë dhe bartës i shumë mirënjohjeve për të arriturat në fushën e mjekësisë dhe të sportit (hendbollit). Mori pjesë në shumë kongrese e seminare dhe botoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. Pas pensionimit jetoi në Zagreb. (Mehmedali Azemi)

GJORGJEVIQ (Đorđević) Petar (1934-). Pedagog dhe kompozitor. Lindi në Prizren. Pas Shkollës së Mesme të Muzikës në vendlindje, kreu studimet në seksionin teorik-pedagogjik të Akademisë së Muzikës në Beograd. Më pas, nga viti 1960 deri në pension, ishte profesor i lëndëve teorike muzikore në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren. Përveç punës pedagogjike, u mor edhe me kompozime dhe aranzhime, posaçërisht me përpunime të këngëve popullore,

pra edhe të këngëve shqipe për kor të përzier. Prej tij kemi këngët e përpunuara shqipe: "Shade mori shoqe", "Fustanin me pika", "Aromë portokalli", "Kur më del në derë" etj. Jeton në Beograd. (Zeqirja Ballata)

GJORGJEVIQ (Đorđević) Vladan (1844-1930). Kryeministër serb, i njohur për veprimtarinë e tij antishqiptare. Lindi në Beograd. Kishte prejardhje armene, nga Maqedonia. Studioi për mjekësi në Universitetin e Vjenës. Pas diplomimit si kirurg, shërbeu vullnetarisht në luftën franko-prusiane. Më pas u kthye në Beograd dhe bëri emër si mjek, duke marrë gradën e oficerit kryesor mjekësor në ushtrinë serbe. Ishte një ndër themeluesit kryesor të Kryqit të Kuq të Serbisë dhe Kolegjit Mbretëror të Mjekësisë. Ai gjithashtu udhëhoqi Partinë Progresive Serbe me Milutin Garashaninin, të birin e Ilija Garashaninit. V. Gjorgjeviq ishte kryeministër i Serbisë në periudhën 1897-1900. Shkroi librin antishqiptar "Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha", që është njëri nga librat më agresivë, me teza antishkencore dhe me gjuhë të urrejtjes ndaj shqiptarëve. (Alban Dobruna)

GJOTA Rifat (1939-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet për inxhinieri elektrike në



RIFAT GJOTA

Fakultetin Elektroteknik (FE) të Universitetit të Shkupit (1965). Punoi si mësimdhënës në gjimnazin e Pejës dhe më pas në "Elektrokosovë" si referent për matje dhe mbrojtje. Studimet e magjistraturës dhe të doktoratës i kreu në FE të Universitetit të Zagrebit (1985). Më 1970 u zgjodh asistent dhe në vitet vijuese merr titujt përkatës universitarë. Pas një pune të gjatë kërkimore, për herë të parë vuri në veprim elektromotorin eksperimental me parim të ri, i emërtuar si "makinat komplementare" (1985). Bëri paraqitjen në kuadër të enteve të patentave në Bernë të Zvicrës (P-1040/85) dhe në Uashington, SHBA (US Patent 4.710.661). Në regjistrin ndërkombëtar të novatorëve, në Institutin e Patentave në Uashington, në mesin e 2300 patentave, radhitet në vendin e parë (1990). Në një ekspozitë në Gjenevë dekorohet me medalje argjendi (1986),

kurse me medalje ari në “Expo ‘89” në Nju-Jork. Në Korporatën Eelektroenergetike të Kosovës u punuan elektromotorët komplementarë të fuqive të ndryshme prej 22-200 kW në 0.4 kV, si dhe një elektromotor me fuqi $P=400$ kW në tension 6 kV. Përveç pjesëmarrjes në shumë ekspozita ndërkombëtare shkencore, R. Gjota botoi edhe librin “Makinat elektrike komplementare-komplekse I” (2005), në të cilin janë analizuar mundësitë për eliminimin e harmonikëve të lartë invers te mbështjellat e lidhura në yll apo në trekëndësh në motorët klasikë induktivë. (Ali Gashi).

GJOVI Pal (Paolo Gioivo) (1483-1552). Titullar i kishës katolike, historian, biograf, figurë e shquar e Rilindjes italiane. Lindi në Komo (provincë e Italisë), mbaroi studimet për mjekësi në Pavia dhe në Padova, më pas u vendos në Romë, ku qëndroi pranë papës Leoni X. Shërbeu edhe si mjek i papës Klementi VII. Në kohën e papës Pali III u largua nga Roma për në Firence, në shërbim të dukës Kozimo de Medici. Në vilën e tij (Vila Pliniana, afër Komos) të kthyer në muze është ruajtur koleksioni me portretet e njerëzve të shquar të kohës së tij, në mesin e të cilëve dhe portreti origjinal i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, i piktorit Kristofano Dell’Altissimo, sipas një vizatimi origjinal të piktorit Bellini, bashkëkohës i Skënderbeut. Portreti i Skënderbeut, i punuar në vaj, edhe sot ndodhet në galerinë “Galleria degli Uffizzi”. Në veprën e tij “Elozhe për burrat e shquar të artit luftarak dhe të burrave të shquar të letërsisë” (Bazel, 1575/1577) një vend të veçantë ia kushton Skënderbeut (lib. III, f.144-147, me një portret gravurë të princit arbëror në faqen e parë, me titullin: “Elozhe për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Princ i Epirit”), si dhe në veprën e mëhershme “Komente mbi bëmat e turqve dhe të Skënderbeut, princit të Epirit” (Venedik, 1541.) etj. (Gjon Berisha)

GJUNETIA. Është aktiviteti më i vjetër njerëzor, që ka një histori të lashtë. Në Kosovë nismat e para të gjuetisë datojnë në fillim të viteve ‘30 të shekullit XX. Gjuetia e organizuar në Kosovë daton më 25 shtator 1949, me mbajtjen e Kuvendit të Parë të Gjuetarëve të Kosovës, që u emërtua Nënlihdja e Gjahtarëve të Kosovës. Në vitin 1955 u ngrit në Lidhja e Gjahtarëve të Kosovës, e cila u pavarësua në vitin 1974. Përgjatë kësaj kohe ekzistonin 30 shoqata të

gjahtarëve në nivel komunash. Në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjes së shoqatave të gjahtarëve, në Kuvendin e mbajtur në Prishtinë më 25 tetor 2000, Lidhja e Gjahtarëve të Kosovës u emërtua në Federata e Gjahtarëve të Kosovës. Kosova ka një vend gjuetie me destinacion të veçantë, “Blinajën” në Lipjan, që është e nivelit të lartë, të cilën menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. (Ibrahim Muja)

GJUHA SHQIPE. Shqipja standarde dhe varietetet e tjera dialektore e të shkruara të shqipes së hershme të përbashkët. Është gjuhë e parë zyrtare në Shqipëri dhe në Kosovë, ndërsa ka status të gjuhës zyrtare ose është e pranuar si gjuhë pakice në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Itali dhe në Rumani. Dialekte të shqipes pa status zyrtar, të rrezikuara të zhduken, por me përndarje të gjerë, gjenden në Greqi, ku dallohen çamërishtja në Çamëri dhe në zonat veriore të Greqisë rreth Kosturit dhe arvanitika në Atikë, Eube, Beoti, Peleponez dhe ishujt Andros, Speces, Salamina, Hidra, Poros. Mendohet se arbërishtja në Greqi (“arvanitika”) flitet së paku nga shek. XIV. Në Itali, qysh nga shek. XV fliten varietete të arbërishtes në krahinat Abruco, Bazilikata, Kalabri, Kampania, Molise, Pulia dhe në Sicili. Në Kroaci, në Arbanasi te Zara, nga shek. XVIII jeton një komunitet arbëresh me prejardhje nga rrethinat e Tivarit. Të folme të ngulimeve shqiptare ka edhe në disa fshatra në Ukrainë, njihet e folmja e Mandricës në Bullgari, ndërsa më parë ka pasur folës të shqipes edhe në Sllavoni, por kjo e folme është zhdukur tashmë. Një numër i madh shqiptarësh jeton në Turqi, ndërsa në disa fshatra si Çevretepe të Adanasë, në Horoz Gedigi e në Kapiagzi të Tokarit janë komunitete të tëra që ende e kanë ruajtur shqipen, edhe pse ajo atje nuk ka asfarë statusi. Komuniteti i arnautëve në Egjipt dhe Siri (sidomos brezat më të vjetër) është biling, duke folur një variant të shqipes. Ekziston një mërgatë e bujshme shqiptare në Europë, si pasojë e mërgimeve nga Shqipëria dhe Kosova, sidomos në disa dekadat e fundit. Kjo ka bërë që të ketë komunitete të gjera të folësve të shqipes në shtetet perëndimore të Europës, sidomos në Gjermani, Zvicër, Itali, Greqi, por edhe në Francë, Austri, Holandë, Belgjikë, shtete të Skandinavisë, Britani të Madhe etj. Komunitete që flasin variante të shqipes ka edhe në SHBA,

Argjentinë, Brazil, Australi, Zelandë të Re. Disa varietete të shqipes, përfshirë të folmet e arbëreshëve të Greqisë, të arbneshëve të Zarës e kështu me radhë, janë të rrezikuara të zhduken. Shqipja në kuadër të gjuhëve indeoeuropiane përbën degë më vete. Bën pjesë në grupin e gjuhëve të tipit satem, tok me gjuhët sllave, gjuhët baltike, gjuhët indo-iranike dhe me armenishten. Ideja për prejardhjen ilire të shqipes është më e vjetra dhe ka tashmë një histori të gjatë. Kjo tezë mbështetet në faktin se shqipja e sotme flitet në territorin e dikurshëm të ilirëve, se në ato hapësira do të jetë folur dhe në lashtësi, se disa glosa dhe toponime ilire mund të shpjegohen me fjalë të shqipes së sotme, se shqipja përfshin huazime greke të vjetra dhe latine që dëshmojnë kontakte të hershme të shqipes me ato gjuhë. Këtyre u shtohen edhe të dhënat arkeologjike. Ekziston edhe teza për prejardhjen trakase të shqipes, çka do të thotë se do të ketë pasur një zhvendosje nga viset lindore të Ballkanit drejt hapësirave ku flitet ajo sot. Dëshmi për këtë shkenca nuk ka njohur deri sot. Leksiku i shqipes ka shtresa të huazimeve nga greqishtja e vjetër, e mesme dhe e re, nga latinishtja, nga sllavishtja, nga turqishtja, nga gjuhët neoromane. Në vitet e fundit ka një presion huazimesh nga anglishtja. Megjithatë, shqipja ka ruajtur një fond të vetin të fjalëve të lashta.

Shqipja e sotme përfshin shqipen e njësuar standarde, variantet letrare, të folmet dialektore, varietetet e diasporës historike dhe të mërgatës. Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, dialektin e veriut, gegë, dhe atë të jugut, toskë, që kanë disa ndryshime në sistemin fonetik dhe atë gramatikor. Disa nga dallimet dialektore të shqipes janë më të hershme e disa më të vonshme. Këto dy variante mund të ndiqen qysh nga shkrimet e para të shqipes. Dokumentet e para të njohura të shqipes i përkasin shek. XV, ndonëse ka hipoteza për mundësinë e ekzistimit të dokumenteve më të hershme. Në Mesjetë, folësit e saj e kanë quajtur veten arbër, ndërsa gjuhën arbërishte. Emërtimi *shqip* është përdorur në shkrim të Buzuku (1555), me kuptimin qartë, troç. Si emërtim për etninë e gjejmë së pari në fillim të shekullit XVIII në tekstet e Kuvendit të Arbënit. Gjuha shqipe përmendet për herë të parë në shekullin XIII. Gjuha letrare shqipe është shkruar me alfabetet e ndryshme në periudha të ndryshme

të historisë, ndërsa tani shkruhet me alfabetin latin të përbërë nga 36 shkronja, mbështetur në përpjekjen për njësimin e shkrimit të shqipes në Kongresin e Manastirit më 1908. Gjuha letrare shqipe është sanksionuar me Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, me bazë mbi toskërishten. Para kësaj, ka qenë e standardizuar më 1918 mbi bazën e së folmes së Elbasanit që nuk është marrë parasysh në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore. Në Jugosllavinë e para Luftës së Dytë Botërore shqipja nuk ka qenë gjuhë e lejuar për përdorim publik. Në ish-Jugosllavi ka pasur statuset e ndryshme sipas rrethanave politike shtetërore. Në Kosovë, po ashtu, ka pasur disa mbledhje e konferenca për problemet e shqipes. Në 1952 qe vendosur që gegnishtja e mesme të jetë gjuhë letrare, ndërsa drejtshkrimi i fundit i hartuar në Kosovë është ai i vitit 1964, kurse në Konsultën e vitit 1968 në Prishtinë qe nxjerrë një rezolutë që bënte gjuhë letrare në Kosovë “Projektin e rregullave të ortografisë” të vitit 1967 të Tiranës, duke hapur rrugën për gjuhë të përbashkët letrare. Regjistrimi fonik më i vjetër i shqipes është realizuar nga Jokli më 1904 dhe paraqet një folës nga rrethina e Gostivarit.

Variantet e arbëreshëve të Greqisë, të Italisë dhe të shqiptarëve nga Ukraina janë toske, ndërsa ai i arbneshëve të Zarës është gegë. Shqipja standarde, derisa është gjuhë e administratës dhe e shkollës në Kosovë, në Shqipëri dhe në hapësirat shqiptare në Maqedoni, vazhdon të jetë varianti më i shpeshtë i medimeve, ndonëse varësisht nga dizajni i audiencës dhe politikat redaktuese të medimeve, shfaqen variante të tjera të shqipes. Standardi i shqipes vazhdon të elaborohet nga Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe, i përbërë nga gjuhëtarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe diaspora, si “autoritet shkencor për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me përdorimin dhe zhvillimin e shqipes standarde”.

Në pikëpamjet tipologjike, shqipja është gjuhë sintetiko-analitike, me sistem prej 36 fonemash: 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore. Ka sistem rasor me pesë rase, dy gjini (e treta, asnjansja në zhdukje), ka kundërvënien e shquarsisë dhe të pashquarsisë, ka një të paravendosur dhe të prapavendosur dhe eptim të brendshëm në sistemin emëror dhe në atë foljor (plak-pleq, narth- nerth). Sistemi

i numrave nga 11 deri në 19 është krijuar në kompozita, sipas të cilave kemi mbivendosjen e numrit njësh mbi dhjetën (një-mbë-dhjetë), ka sistemin dhjetor (tridhjetë, pesëdhjetë) ndërsa ka edhe sistem vigesimal (njëzet dhe dyzet - ky i fundit me konkurrencë të formës dhjetore katërdhjetë). Në sistemin foljor ka mënyrën dëftore, lidhore, dëshirore, habitore, urdhërore dhe kushtore (kjo e fundit, ndonëse pjesë e thuasje të gjitha gramatikave të shqipes, megjithatë nuk është e gramatikalizuar) si dhe format e pashtjelluara pjesore, paskajore dhe përcjellore. Kohët e foljeve të saj kanë kundërvënien në rrafshin e orientimit në raport me boshtin e ligjërimit, por edhe në nivelin e diskursit në kohë rrëfimi dhe kohë komenti si dhe në rrafshin e aspektit e të vazhdimësisë përgjithësisht. Koha e ardhme realizohet në dy forma analitike: me formën e ngurosur *do (dua)* + forma e lidhore ose paskajorja dhe me foljen ndihmëse *kam* + paskajore, qoftë e ashtuquajtura toske: *për të punuar*, qoftë geqe (*me punu*). Struktura gramatikore e shqipes përfshin disa veçori të ashtuquajtura ballkanike që korrespondojnë me disa gjuhë të tjera të arealit gjuhësor ballkanik: rumanishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja e re ose dialekti torllak i serbishtes.

Derisa “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” si dhe gramatikat e strukturës së shqipes janë veprat bazë të albanistikës, studimet e para të mirëfillta për shqipen dokumentohen në fillim të shekullit XVIII, kur shtypen gramatikat e para, ndërsa para kësaj kemi interesimin për leksikun e shqipes, përmes fjalorit të Frang Bardhit (1635). Në shek. XVIII dhe XIX ka interesim për historinë e shqipes, ndërsa më 1854 Franc Boppi argumentonte se shqipja formon degë më vete në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Gjatë Rilindjes Kombëtare ka pasur interesim të shtuar të vetë shqiptarëve për shqipen. Naum Veqilharxhi më 1845 botoi “Ëvetarin”, ndërsa më 1879 u formua “Shoqata e të shtypurit shkronja shqip”. Studimet e shqipes sot përfshijnë sfera të ndryshme interesimi prej albanologëve nga mbarë bota. (Bardh Rugova)

GJUHËT NË KOSOVË. Ligjet e Republikës së Kosovës kanë sanksionuar shqipen dhe serbishten si gjuhë zyrtare, ndërsa tri gjuhë të tjera: bosnjishten, turqishten dhe romishten si gjuhë zyrtare në nivel komune. Së këndejmi, në Kosovë fliten gjuha shqipe, gjuha serbe

dhe bosnase (kompleksi serbisht-bosnisht-malazezisht-kroatisht bashkë me idiomën gorane), gjuha turke dhe gjuha rome. Neni 5.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë “gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe”, kurse paragrafi 5.2. shton: “Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin. Ligji për përdorimin e gjuhëve nr 02/L-37 I vitit 2006 në nenin 2.1 ka sanksionuar që “gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë”, ndërsa në paragrafin 3 ligji ka specifikuar: “Në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 për qind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë”, për të vazhduar në të njëjtin paragraf se “në komunën e Prizrenit, gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare”. Në komunat ku një bashkësi etnike përfaqësohet nga më shumë se 3 për qind e popullatës, gjuha e saj do ta ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar. Dispozitat e këtilla ligjore e vënë Kosovën në një pozitë më të avancuar nga vendet e rajonit, sa u përket standardeve për gjuhët e pakicave. Në frymën e Kartës Europiane të Gjuhëve Rajonale apo Minoritare, sipas së cilës “gjuhët rajonale apo minoritare” karakterizohen me faktin se: a. fliten në një territor të një shteti nga pjesëtarë që përbëjnë grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së shtetit dhe b. janë të ndryshme nga gjuha (gjuhët) zyrtare të atij shtetit, duke mos përfshirë as dialektet e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit as gjuhët e migrantëve, gjuhë minoritare në Kosovës, në rrafsh nomenklature, mbeten: turqishtja, bosnjishtja dhe romishtja. Në aspektin e dallimeve në realitetet gjuhësore në terren jo gjithnjë është e lehtë të veçohet serbishtja nga bosnjishtja e sidomos nga gjuha e kroatëve dhe e malazezëve që përbëjnë një pakicë fare të vogël. Pas vitit 1999 në Kosovë fliten gjuhët e migrantëve me status që nuk varet nga shteti i Kosovës: anglishtja e institucioneve ndërkombëtare, gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja dhe gjuhë të tjera të komuniteteve të administratës ushtarake, policore, ligjore e politike në Kosovë. Folësit e këtyre gjuhëve rrallë e nxënë gjuhën e vendit. Pavarësisht

nga statusi, anglishtja shpesh imponohet si gjuhë e ligjeve dhe shërben gjithnjë si gjuhë e komunikimit midis komuniteteve të ndryshme ndërkombëtare dhe vendorëve e ndërkombëtarëve. Në kuadrin e trashëgimisë kulturore, pos gjuhëve të tashme zyrtare në Kosovë duhet veçuar edhe çerkezishtja. Në aspektin statistikor, shqipja flitet nga afër 92 për qind e popullatës, serbishtja-bosnjishtja-kroatishtja-malazezishtja në afër 7 për qind, romishtja në rreth 1 për qind dhe turqishtja në 0,5 për qind (vlerësime në mungesë të statistikave zyrtare).

Shqipja e Kosovës bën pjesë kryesisht në kuadrin e të folmeve verilindore të gegërishtes, ndonëse ka edhe disa të folme të gegërishtes veriperëndimore, ndërsa në pjesën më jugore të të folmeve të Kaçanikut shkohet drejt të folmeve të gegërishtes së mesme. Në Kosovë ka dallime mes grupit të të folmeve të Rrafshit të Dukagjinit (Deçan-Gjakovë) dhe Fushës së Pejës e të folmeve të Drenicës në një anë dhe të folmeve të Rrafshit të Kosovës, të Moravës së Epërme, të Karadakut, të Llapit e Gollakut në anën tjetër. E folmja e muhaxhirëve të shpërngulur në shek. XIX nga Toplica e Kosanica është shkruar në të folmet e Rrafshit të Kosovës. Shqipja popullore ka qenë gjuhë e popullatës shumicë në Kosovë gjatë periudhës osmane dhe gjatë sundimit të ish-Jugosllavisë. Mirëpo, ajo në Kosovë është shkruar që herët. Pjetër Budi botoi në shek. XVII. Budi në veprën e tij përmend një botim të mëhershëm të Palit të Hasit, i cili nuk është ruajtur. Më vonë ka shkrime të Gjon Nikollë Kazazit, të Tahir Efendi Boshnjakut, të Ndue Bytyçit, Shtjefën Gjeçovit e të tjerë. Në periudhën 1941-1945 janë hapur shkolla në gjuhën shqipe në Kosovë, ndërsa pas vitit 1945 ka pasur vllug të alfabetizimit të popullatës, që është përcjellë edhe në selitjen e shqipes së shkruar. Sot shqipen në Kosovë e flasin të gjithë shqiptarët, ashkalinjtë, egjiptasit, një pjesë e romëve. Krahas gjuhës së tyre shqipen e mësojnë edhe turqit, një pjesë e goranëve, ndërsa më pak e boshnjakëve dhe e serbëve.

Serbishtja e Kosovës është pjesë e tërësisë dialektore të serbishtes dhe i përket dialektit të ekavishtes me dy nënndarje kryesore: në Kosovën Veriore flitet dialekti "kosovsko-resavski", ndërsa në pjesët juglindore dialekti i njohur si "prizrensko-južnomoravski" (ose "prizrensko-timočki") e disa e shohin si dialekt

torllak, ku përfshijnë të folmet e kufirit Kosovë-Maqedoni, Serbi-Maqedoni dhe Serbi-Bullgari. Të folmet juglindore serbe kanë më shumë tipare ballkanike. Kroatët e Janjevës gjuhën e tyre e quajnë kroate, por për nga veçoritë gjuhësore ajo i përket dialektit "prizrensko-južnomoravski". Në zona të ndryshme ka pasur kolonizim nga zona të ijekavishtes. Serbishtja e Kosovës në dokumente zyrtare shkruhet me alfabet latin ose cirilik. Boshnjakët e Kosovës, kryesisht të ardhur nga Sanxhaku, gjuhën e tyre e quajnë "bosanski".

Turqishtja e Kosovës ka mbetur si gjuhë me përdorim familjar nga koha e sundimit osman në Prizren, në Mamushë dhe në Dobërçan. Më herët ka pasur përdorim të veçantë sociolektal në qendrat si Prishtina, Gjilani, Peja, Vushtrria e Mitrovica, ku ende mund të dëgjohet nga folës bilingë. Ka status të gjuhës zyrtare në Prishtinë, në Prizren, në Mamushë, në Gjilan dhe në Mitrovicë. Mësohet në shkollë deri në nivel universitar.

Romishtja është gjuhë e romëve. Është gjuhë e shkollës dhe ka emisione televizive në gjuhën rome. Ka disa varietete. Romishtja është gjuhë indoeuropiane e grupit indas. Në Prishtinë ka status të gjuhës zyrtare. Ashkalinjtë dhe egjiptasit gjuhë amtare e kanë shqipen. Deri nga fundi i shek. XX në Kosovë është folur edhe idioma e njohur si çerkezishte, e folur nga çerkezë të ardhur nga Kaukazi përmes ushtrisë osmane. Në Stanoc të Poshtëm të Vushtrrisë ka pasur një komunitet që është shpërngulur në Republikën e Adigesë në Federatën e Rusisë. Më herët nëpër vise të Kosovës mund të jetë folur edhe vllahishtja (variant i rumanishtes) mesjetare.

Kontaktet e gjuhëve në Kosovë kanë lënë gjurmë te njëra-tjetra, varësisht nga kahet e huazimeve. (Bardh Rugova)

GJUKA Sali (1876-1925). Jurist, mësues, nënshkruar i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë. Lindi në Pejë. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmen në Shkup. Mbaroi Fakultetin e Drejtësisë në Selanik dhe më pas punoi në gjykatën këtij qyteti. Në vitin 1909 ndihmoi hapjen e shkollës shqipe në Pejë. Në vitin 1910 ishte mësuesi i parë i shqipes për nxënësit shqiptarë në Shkollën Normale dhe gjimnazin e Shkupit. Ishte një nga drejtuesit e gazetës "Bashkimi i kombit" në Manastir. Dha një kontribut të çmuar në kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912. Me

nismën e tij, në prill të vitit 1912 në Selanik u formua Klubi "Bashkimi", i cili synonte arsimimin e shqiptarëve dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Si përfaqësues nga Kosova dhe delegat i Shkupit, Pejës, Gjakovës, Plavës e Gucisë mori pjesë në Kuvendin e Vlorës më 28 Nëntor 1912 dhe nënshkroi Deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë. U zgjodh këshilltar i Pleqësisë (Senatit) dhe ndihmës i ministrit të Arsimit, Luigj Gurakuqit. Në janar të vitit 1913 filloi punën si drejtor i arsimit për qarkun e Beratit, ku hapi Shkollën Normale të përkohshme dhe ku pjesa më e madhe e nxënësve ishin nga Kosova, të cilët, më pas, shkuan në vendlindje dhe çelën shkolla në gjuhën amtare. Më 1915 punoi në Shkodër, bashkë me Mustafa Qullin dhe Sali Nivicën për të nxjerrë gazetën "Populli". Botoi shumë artikuj për çështje të gjuhës, etnografisë etj. Ishte ndër organizatorët e Kongresit të Lushnjës të vitit 1920. Po atë vit u akuzua për pjesëmarrje në vrasjen e Abdyl Ypit. Për këtë e dënuan 10 vjet burg, 4 nga të cilat i vuajti. Përkrahu Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924. Vdiq në Berat, i sëmurë nga tuberkulozi. (Fitim Rifati)

GJUKA Sami (1953-). Piktur. Lindi në Pejë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë. Kreu studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Bruksel dhe në Amsterdam. Hapi disa ekspozita personale, nga të cilat më të rëndësishmet janë: në Pejë (1971), pastaj në Cazin (1978), Sarajevë (1979), Dubrovnik (1979), Zarë (1980), Karlovc (1985), sërish në Dubrovnik, në Galerinë "Rosario" (1986), më vonë në Stamboll, në Galerinë "Opera" (1999) dhe së fundi në Nju-Jork (2010), në Amsterdam (2014), në Braga (Portugali) dhe në shumë qendra të tjera europiane. Gjatë viteve tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë jetoi si piktor i lirë në Zagreb dhe Karlovc të Kroacisë, pastaj në Turqi, ndërsa tani jeton e vepron në Suedi. Është i njohur si krijues i konceptimit metafizik të figuracionit kompozicional, sidomos me veprat e realizuara në periudhën e qëndrimit të tij në Kroaci. (Hajrush Fazliu)

GJUKAJ Arben (1974-). Inxhinier i elektroteknikës, menaxher. Lindi në Deçan, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet nga lëmi i elektroteknikës i filloi në Universitetin e Prishtinës dhe i përfundoi në Universitetin Politeknik të Tiranës (2001).

Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin Amerikan të Kosovës në Prishtinë (2007), ndërsa disertacionin e mbrojti në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Tiranë (2015). Punoi si inxhinier në projektin e Bankës Botërore për ndihmë teknike në sektorin e energjisë në Kosovë dhe më pas ishte drejtor ekzekutiv i operatorit të shpërndarjes dhe drejtor menaxhues i Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës. Drejtoi dhe realizoi disa projekte në sektorin e energjisë në Kosovë. Si autor dhe bashkautor mori pjesë me kumtesa dhe referate në konferenca shkencore dhe botoi punime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Isuf Krasniqi).

GJURA Sadudin (1926-1960). Mësimdhënës, veprimtar, shkrimtar. Lindi në Shipkovicë të Tetovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Tetovë. Studioi gjuhën ruse në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Punoi si mësues në disa fshatra të rrethit të Tetovës (Shipkovicë, Çellopek, Prirok), pastaj mësimdhënës i gjuhës shqipe në Vrapçisht dhe në vitin 1951 mësimdhënës në Normalen e Tetovës. U mor edhe me krijimtari letrare. Shkroi poezi dhe drama ("Lalë Bajrami", "Fejesa në djep", "Dervish Cara") etj. Ishte themelues i organizatës ilegale patriotike "Liria", për çka edhe u dënua me 14 vjet burg. Vdekja e tij në rrethana të dyshimta nuk u sqarua. (Hatixhe Vojka-Ismajli)

GJURAVÇAJ Pjetër (1935-). Mësimdhënës dhe studiues. Lindi në Triesh, arsimin fillor e mori në vendlindje, përkatësisht në Tuz, shkollën normale e filloi në Gjakovë dhe e përfundoi në Prishtinë. Studioi gjuhën dhe letërsinë shqipe, fillimisht në Shkollën e Lartë Pedagogjike, përkatësisht në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku diplomoi më 1973. Pasi magjistroi, më vonë mbrojti tezën e disertacionit për metrikën e poezisë gojore të Malësisë së Mbishkodrës. Punën mësimore e filloi në vitin 1955 në shkollën fillore të Arzës, pastaj në Traboin të Moçëm dhe Rraxë të anës së Tuzit. Nga viti shkollor 1961/62 deri në vitin 2005 ishte mësimdhënës përkatësisht drejtor shkolle në Triesh të Epërm. Ishte edhe bashkëpunëtor i Ministrisë së Arsimit të Malit të Zi për çështje të arsimit shqip. Është autor tekstesh shkollore dhe studimesh nga fusha e folklorit dhe e etnologjisë. (Palokë Berisha)

GJURIQ (Djurić) Natalija (?-). Arkeologe serbe. Studimet i kreu në Universitetin e Beogradit, punoi kohë të gjatë në Muzeun e Kosovës dhe pastaj u shpërngul në Nish. Hulumtoi dhe botoi rezultatet nga gërmimi i tumave ilire të Shirokës dhe të Dibiçakut te Suhareka dhe në Gërlicë (Gurëz, 1975), pastaj Gradinat në Bellaqefc (Bardh i Madh, 1969) e Cernicë te Gjlani (1969) etj. Mori pjesë në hulumtimet në tumat e Romajës (1970-1973) dhe është bashkautore e botimit të rezultateve në librin “Romaja parahistorike”. Pos tjerash, botoi artikullin mbi “Hyjneshën” e Barilevës, bashkëkohëse e “Hyjneshës në Fron” dhe kontribuoi për hapjen e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit. (Edi Shukriu)

GJURIQ Slagjana (Slađana Đurić) (1964-). Sociologe, profesoreshë universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Fakultetin e mbaroi në katedrën e filozofisë dhe të sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Shkollën Juridike në Beograd, ku mbrojti edhe tezën e doktoratës. Më 1987 filloi punën në UP asistente e sociologjisë së përgjithshme. Pas një periudhe të punës në këtë universitet, kaloi në Universitetin e Beogradit. Ka botuar disa libra, ndër të cilat edhe studimin monografik “Hakmarrja dhe ndëshkimi. Hulumtim sociologjik i gjakmarrjes në Kosovë dhe Metohi”. Disa vjet ligjërroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, ndërsa aktualisht punon në universitetin serb të Mitrovicës së Veriut. (Anton K. Berishaj)

GJURKAJ Shyqri (1949-). Piktore. Lindi në Pejë, ku kreu Shkollën e Mesme të Artit. Akademinë Pedagogjike dhe Akademinë e Arteve, dega e pikturës, i kreu në Sarajevë (1976).



SHYQRI GJURKAJ

Është anëtar i SHAFK-ut nga viti 1978 dhe anëtar i Lidhjes së Artistëve të UNESCO-s. Deri më 1999 ishte mësimdhënëse e artit figurativ në shkollat e mesme në Pejë, pastaj u vendos në Suedi, ku jeton dhe vepron aktualisht. Hapi disa ekspozita personale, si në Galerinë ET në Sarajevë (1984), në Qendrën Kulturore Jugos-

llave në Hamburg (1985), në Qendrën Kulturore Jugosllave në Nju-Jork (1989), në Sor-garn të Suedisë (1993, 2001), pastaj në Poloni, në Danimarkë, sërish në Suedi, në Karskrona (2013) etj. Mori pjesë në një sërë ekspozitash të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit dhe është laureat i disa çmimeve: i çmimit të parë për pikturë në Sallonin Pranveror të Kosovës (1980), çmimin e parë në Trienalen Jugosllave të Vizatimit në Sombor (1984), çmimin e parë për pikturë në “Bienalen Ndërkombëtare” më 1998 në Poloni etj. Vepra e tij paraqet realen, të shndërruar në atë që ndjen njeriu në veten e tij, ndërsa në disa punime u përfshi guri si simbol qëndrese. (Hivzi Muharremi)

GJURKAJ-QENA Igballe (1951-). Aktore. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën e aktrimit, e kreu në vitin 1970, në Prishtinë. Realizoi një sërë rolesh në teatër, film, televizion dhe radio. Nga rolet e saj të shumta, spikat rolet në shfaqjet: “Milionerët e Napolit” në Teatrin Popullor Krahinor (1984), “Zhorzh Danden” (1988), “Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër”



IGBALLE
GJURKAJ-QENA

(1989). Nga angazhimet e saj në shfaqjet teatrorë në vitet '90 shquhet në shfaqjet: “Babai” (1992), “Garderobisti” (1996), ndërsa nga rolet e shumta të interpretuara në Tetarin Kombëtar të Kosovës pas vitit 2000 shquhet me rolet në shfaqjet “Hamleti” (2000), “Rikardi III” (2002), “Vrima e lepurit” (2013), “Vdekja e një komisioneri” (2014), “Trojanët” (2015) etj. Gjithashtu luajti edhe një sërë rolesh në filma të metrazhit të shkurtër dhe të gjatë (“Migjeni”, “Babadimri”, “Liza”, “Zonjusha” etj.) dhe në drama dhe seriale televizive, si dhe në radiodrama dhe emisione të tjera radiofonike. Për punën e saj u shpërblye me shumë çmime dhe mirënjohje, ndër të cilat: çmimi për kreacion artistik për rolin e Gertrudës në shfaqjen “Hamleti” (2000), çmimi i parë “Hyjneshë në Fron” për rolin kryesor në filmin “Hijet e luftës” (2002), kurse në vitin 2012 u nderua me Medaljen Presidenciale të Meritave. (Besim Rexhaj)

GJURRGJEALA Bashkim (1949-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Rahovec, shkollën fillore

dhe të mesme i kreu në Prizren, Fakultetin e Makinerisë, degën e termoteknikës në Universitetin e Zagrebit (1974). Në vitet 1974-1977 punoi në fabrikën e fijeve sintetike “Progres” në Prizren. Nga viti 1977 dhe më tej punoi në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), në detyra të ndryshme, deri në vitin 2012 kur u pensionua. Kreu disa specializime: për turbina në Gjermani, për gjeneratorët e avullit në Francë, për efikasitetin e stabilimenteve industriale në Suedi etj. Mori pjesë në shumë simpoziume me punime autoriale në lëmin e energjetikës dhe punoi në studimin e fisibilitetit për zëvendësimin e lëndës djegëse (mazutit), në projektin për zgjerimin dhe rehabilitimin e Ngrohtores së Qytetit të Gjakovës etj. Është autor i librit “Efikasiteti punues i termocentralit elektrik” (2007), si dhe i një sërë publikimesh të ndryshme nga lëmi i energjetikës, i mbrojtjes së mjedisit, i shfrytëzimit eficient të energjisë etj. (Fejzullah Krasniqi)

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVJTJE E KOSOVËS. Institucion i shkallës së dytë dhe i shkallës së tretë i kundërvajtjes me seli në Prishtinë. Si gjykatë e shkallës së dytë vendos lidhur me ankesat e paraqitura ndaj aktvendimeve të gjykatave komunale për kundërvajtje, ndërsa si gjykatë e shkallës së tretë vendoste për mjetin e jashtëzakonshëm juridik: “kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktvendimit të formës së prerë”. Në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje vendimet i merr trupi gjykues prej tre gjyqtarësh. Kjo gjykatë ushtron mbikëqyrjen e punës së gjykatave komunale për kundërvajtje. (Fejzullah Hasani)

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS. Instanca më e lartë për interpretimin e Kushtetutës, përkatësisht për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve me Kushtetutën e Kosovës. U themelua në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në janar të vitit 2009. Para kësaj Kosova kishte Gjykatë Kushtetuese vetëm sipas Kushtetutës së KSAK-së të vitit 1974, ndërsa gjatë periudhës së UNMIK-ut ka vepruar Paneli i Posaçëm i Gjykatës Supreme, me përgjegjësi të shqyrtimit të kushtetutshmërisë së akteve ligjore të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Gjykata përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të cilët emërohen nga presidenti i Republikës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat



nëntëvjeçar. Vendimi për të propozuar shtatë gjyqtarë miratohet me dy të tretat e deputetëve të Kuvendit, ndërsa për dy gjyqtarë kërkohet shumica e dyfishtë e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë si formë e garantimit të së drejtës në përfaqësim të grupeve pakicë. Që nga themelimi i saj, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i janë referuar raste të shumta, përfshirë edhe ato me konotacion politik. Në vitin 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi për papajtueshmërinë e postit të presidentit të vendit me atë të kryetarit të një partie politike, duke nxitur kështu dorëheqjen e presidentit Fatmir Sejdiu. Në mars të vitin 2011, kjo gjykatë e ka vlerësuar jokushtetuese mënyrën e zgjedhjes një muaj më parë të presidentit nga ana e Kuvendit të Kosovës, duke nxitur në këtë rast dorëheqjen e Behgjet Pacollit. Pas zgjedhjeve të qershorit 2014, presidentja Atifete Jahjaga ka kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese rreth kuptimit të grupit më të madh parlamentar dhe të çështjeve që lidhen me të. Më pas, Partia Demokratike e Kosovës ka kontestuar zgjedhjen e Isa Mustafës për kryetar të Kuvendit të Kosovës dhe me atë rast Gjykata Kushtetuese ka konstatuar shkelje gjatë zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit. Për pasojë i tërë procesi i zgjedhjes së kryetarit dhe kryesisë së Kuvendit është përsëritur në fillim të dhjetorit. Si kundërtënëse është parë mënyra e vazhdimit të mandatit të tre anëtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Sipas dispozitave kushtetuese, prania e anëtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese është paraparë për një mandat. Pas shkëmbimit të letrave ndërmjet presidentes Jahjaga dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, anëtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese u është vazhduar mandati për një periudhë dyvjeçare. (Iilir Dugolli)

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS. Instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë, me juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Përbërja e Gjykatës Supreme pasqyron përbërjen etnike të popullatës së Kosovës. Së paku 15% të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por asnjëherë më pak se 3 gjyqtarë, vijnë nga radhët e komunitetit që nuk është shumicë në Kosovë. Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë. Ajo shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga 3 gjyqtarë profesionistë, duke vendosur lidhur me ankesën në shkallë të tretë për rastet e parashikuara me ligj; për kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës; për revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë të gjykatave në çështjet kontestimore; përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës; për lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronave; për lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe çështje të tjera të parapara me ligj. Gjykata Supreme mund të thërrasë një seancë të përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve të saj për nxjerrjen e vendimeve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve. Gjykata Supreme ka edhe dhomën e posaçme dhe ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha kontestet që lidhen me procesin e privatizimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Dhoma e Posaçme përbëhet nga një numër gjyqtarësh (deri në njëzet), dymbëdhjetë prej të cilëve duhet të jenë shtetas të Kosovës, ndërsa 8 duhet të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë. Së paku dy nga gjyqtarët vendorë duhet të jenë nga komunitetet pakicë. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, të cilët janë shtetas të Kosovës, me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Misioni European për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes emëron, riemëron dhe shkarkon gjyqtarët ndërkombëtarë të Dhomës së Posaçme, në pajtim me rregullat dhe procedurat e brendshme të Misionit European për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Kryetari i Dhomës së Posaçme zgjidhet nga gjyqtarët e Dhomës së Posaçme. Çdo kolegji i specializuar përbëhet nga një gjykatës ndërkombëtar dhe dy gjykatës që janë shtetas të Kosovës. Për secilin kolegji të specializuar, kryetari i Dhomës

së Posaçme, pas konsultimit me presidentin e Kosovës dhe Misionin European për Politika të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, emëron një gjykatës që do të shërbejë si kryesues i kolegjit. Dhoma e Posaçme ka presidiumin e saj, të përbërë nga kryetari dhe kryesuesit e pesë kolegjeve të specializuara. Dhoma e Posaçme ka kolegjin e apelit, kryesuesit e të cilit është kryetari i Dhomës së Posaçme. Kolegji i apelit ka kompetencë ekskluzive të apelit në shkallë të fundit. Kolegji i apelit përbëhet nga 5 gjyqtarë, 2 prej të cilëve janë gjyqtarë të EULEX-it, pra ndërkombëtarë. Me kërkesën e bazuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vendos që kolegji të përbëhet me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it. (Fejzullah Hasani)

GJYKATAT E QARKUT. Institucione gjyqësore që vendosin në shkallë të dytë lidhur me ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale. Funksionojnë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë. Ndërkaq, në shkallë të parë gjykojnë për veprat penale për të cilat me ligj parashihet dënimi me mbi pesë vjet burg, për veprat penale për të cilat me ligj të veçantë është parashikuar kompetenca e gjykatës së qarkut, kontestet mbi vërtetimin dhe kundërshtimin e atësisë, përkatësisht amësisë, kontestet lidhur me ekzistimin ose mosekzistimin e martesës, anulimin e martesës ose shkurorëzimin. Gjykatat e qarkut vendosnin gjithashtu edhe mbi kontestet lidhur me alimentacionin ligjor, kur vendoset bashkë me kontestet lidhur me ekzistimin ose mosekzistimin e martesës, mbi anulimin e martesës ose shkurorëzimin apo mbi vërtetimin ose mbi kundërshtimin e atësisë, përkatësisht amësisë mbi të besuarit e fëmijëve për ruajtje dhe edukim, kur vendosin mbi kontestet mbi ekzistimin ose mosekzistimin e martesës, mbi anulimin e martesës dhe shkurorëzimin. Gjykatat e qarkut vendosnin edhe për kontestet që kanë të bëjnë me kërkesat pasurore-juridike, për ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen ose përdorimin e shpikjeve, mostrave, modeleve ose damkave, si dhe me të drejtat e përdorimit të firmës. Gjykatat e qarkut vendosnin edhe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja, japin ndihmën juridike-penale ndërkombëtare me kërkesë të organit të huaj, zhvillojnë procedurën dhe vendosnin mbi lutjen e shtetit të huaj për dorëzimin e personave të pandehur dhe të dënuar, zhvillonin procedurën dhe vendosnin mbi

lutjen për fshirjen e dënimit dhe mbi lutjen për pushimin e masave të sigurimit, vendosnin edhe mbi konfliktin lidhur me kompetencën e gjykatave komunale në territoret e veta. (Fejzullah Hasani)

GJYKATAT KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE. Institucione themelore të vendosjes për kundërvajtje. Gjykatat e kundërvajtjeve janë të organizuara sikurse edhe gjykatat komunale në të gjitha komunat e Kosovës (përveç asaj të Fushë-Kosovës). Gjykatat për kundërvajtje janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës. Ato janë të organizuara në dy nivele: në gjykatat për kundërvajtje në shkallë të parë vendos gjyqtari i vetëm, i cili vendos edhe për kërkesat për përsëritjen e procedurës, ose lidhur me prapësimin kundër vendimeve të dhëna në shkallën e parë. (Fejzullah Hasani)

GJYKATAT KOMUNALE. Institucione themelore gjyqësore të organizuara si gjykata ose degë të gjykatave komunale, deri në themelimin e gjykatave themelore. Këto gjykata më herët vepronin si Gjykata Komunale në Prishtinë (me degën e saj në Graçanicë), Gjykata Komunale në Ferizaj (me degën e kësaj gjykatë në Shtërpçë), si dhe gjykatat komunale në Podujevë, Lipjan, Drenas, Kaçanik, Gjilan, Viti, Kamenicë, Mitrovicë, Leposaviq, Zubin-Potok, Vushtrri, Skënderaj, Pejë, Klinë, Istog, Deçan, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Dragash. Gjykatat komunale vendosin në shkallë të parë për veprat penale, për të cilat vendos gjyqtari i vetëm, pastaj për veprat penale për të cilat si dënim kryesor është paraparë dënimi me gjobë, dënimi me burg deri në pesë vjet nëse me ligj nuk është paraparë kompetenca e ndonjë gjykate tjetër, si dhe për çështje të tjera të përcaktuara me ligj. Gjykatat komunale vendosin edhe në procedurën kontestimore dhe atë jashtëkontestimore, në procedurën e ekzekutimit (përmbarese) në çështjet personale dhe ato civile, si dhe kryejnë punë të ndihmës juridike. (Fejzullah Hasani)

GJYKATAT THEMELORE. Gjykatat e instancës së parë, që zëvendësuan gjykatat komunale. Në Kosovë ekzistojnë 7 gjykata themelore: Gjykata Themelore e Prishtinës (për territorin e komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Drenasit dhe të Graçanicës); Gjykata Themelore

e Gjilanit, (për territorin e komunës së Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Klllokotit dhe Vërbocit); Gjykata Themelore e Prizrenit (për territorin e komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës); Gjykata Themelore e Gjakovës (për territorin e komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit); Gjykata Themelore e Pejës (për territorin e komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës); Gjykata Themelore e Ferizajt (për territorin e komunës së Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit) dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës (për territorin e komunës së Mitrovicës Jugore dhe të Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zubin-Potokut, Zveçanit, Skënderajt dhe Vushtrrisë). Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe, si dhe për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe të vendosin për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja. (Fejzullah Hasani)

GJYQËSIA E KOSOVËS NË KOHËN E UNMIK-ut (1999-2008). Pas vendosjes së administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në sistemin gjyqësor të Kosovës u krijua konfuzioni, sepse fillimisht pjesëtarët e KFOR-it vepronin në zonat që i mbulonin sipas të drejtës së shteteve të tyre. Me qëllim të plotësimin të vakuimit juridik, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së, me rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/1 dhe nr. 1999/24, si legjislacion të aplikueshëm në Kosovë vendosi legjislacionin, i cili me datë 22 mars 1989 ishte në fuqi në Kosovë. Kësisoj vazhduan punën gjykatat komunale dhe të qarkut, ndërsa me rregulloren nr. 1999/5 ishte themeluar Ad hoc Gjykata e Instancës së Fundit, e cila kishte kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe ad hoc kryeprokurori publik dhe zëvendëskryeprokurori publik. PSSP-ja më 28 qershor të vitit 1999 emëroi gjyqtarë dhe prokurorë publikë me mandat tremujor për ta vazhduar pastaj mandatin e tyre deri në përfundim të mandatit të UNMIK-ut. Sipas Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme, në Kosovë kishte Gjykatë Supreme, gjykata të qarkut, gjykata komunale dhe gjykata për kundërvajtje. Në Gjykatën Supreme të Kosovës ishte themeluar kolegji special për çështje kushtetuese. Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, PSSP-ja në cilëndo

fazë të procedurës mund të emëronte gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë në gjykata të qarkut dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës (gjyqtar hetues ose trup gjykues prej tre gjyqtarëve, dy prej të cilëve ishin ndërkombëtar, njëri prej tyre kryetar i trupit gjykues) dhe mund të ndërronte vendin e gjykimit kur vlerësonte se kjo është e nevojshme, për të siguruar pavarësi dhe paanshmëri të gjyqësisë ose administrim adekuat të judikaturës. (Ejup Sahiti)

GJYQËSIA E KSA TË KOSOVËS (1945-1989). Sistemi gjyqësor i Kosovës gjatë periudhës komuniste. Pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë ekzistonin gjykatat e rrethit dhe gjykatat e qarkut. Nga fundi i viti 1963 gjykatat e rrethit emërtohen gjykata komunale dhe themelohet dega e Gjykatës Supreme të Serbisë në Prishtinë, e cila në territorin e Kosovës ushtronte të gjitha punët gjyqësore nga kompetenca e Gjykatës Supreme të Serbisë. Me Kushtetutën Federative dhe atë të Kosovës të vitit 1974, sistemin gjyqësor të KSA të Kosovës e përbënin: gjykatat e rregullta (gjykatat komunale, të themeluara për territorin e një ose disa komunave; gjykatat e qarkut që përfshinin territorin e dy ose më shumë gjykatave komunale dhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në aspektin institucional kishte kompetencë të njëjtë me Gjykatën Supreme Republikane) dhe gjykatat vetëqeverisëse (gjykatat e punës së bashkuar, arbitrazhet, këshillat e pajtimit etj.). Për gjykimin e mosmarrëveshjeve ekonomike ekzistonin gjykatat ekonomike të shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë Ekonomike. Në kuadër të gjykatave vepronte prokuroria publike krahinore. Në bazë të Kushtetutës së KSA të Kosovës të vitit 1974 ishte themeluar edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989 (deri në vitin 1999), sistemi gjyqësor i saj ishte transformuar si pjesë e gjyqësisë së Serbisë, sistem special diskriminues kundër shqiptarëve të Kosovës, i cili më shumë bazohej në ideologji sesa në norma juridike. (Ejup Sahiti)

GJYQËSIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Një kohë pas shpalljes së pavarësisë, në Republikën e Kosovës ekzistonte i njëjti sistem gjyqësor që vepronte në kohën e administratës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Gjatë vitit 2008-2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi legjislacionin e ri për sistemin gjyqësor



PALLATI I DREJTËSISË NË PRISHTINË

të Kosovës, i cili përfshinte ligjet për gjykatat, për Gjykatën Kushtetuese, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për Institutin Gjyqësor të Kosovës, për Prokurorin e Shtetit, për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, për jurisprudencën, avokatinë, noterinë, kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, si dhe për Avokatin e Popullit. Ligjet e sipërpërmendura rregullojnë dhe organizojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë: gjyqësorin, prokurorinë, avokatinë dhe noterinë në frymën e Kushtetutës së Kosovës. Gjithashtu, në fusha të ndryshme të së drejtës, në veçanti në lëmin juridik-penal është aprovuar legjislacionin e ri. Me legjislacionin e ri është synuar reformimi i sistemit gjyqësor, sigurimi i pavarësisë dhe i paanshmërisë së tij dhe sundimi i ligjit. Kësisoj, Ligji për Gjykatat ka përcaktuar një strukturë gjyqësore të ndryshme nga ajo që më parë ekzistonte në Kosovë. Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës përbëhet nga shtatë gjykata themelore (gjykojnë në shkallë të parë), nga Gjykata e Apelit me seli në Prishtinë (gjykon në shkallë të dytë) dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës. Brenda territorit të gjykatave themelore ekzistojnë degët e tyre. Me qëllim të veprimit më efikas të gjykatës përkatëse, brenda territorit të gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit ekzistojnë departamente dhe mund të formohen divizione. Në secilën gjykatë themelore ekziston departamenti i përgjithshëm, i cili vepron në selinë e secilës gjykatë themelore si dhe në secilën degë të saj, departamenti për krime të rënda, si dhe departamenti për të mitur, që vepron në selinë e secilës gjykatë themelore. Departamenti

për çështje ekonomike dhe departamenti për çështje administrative ekziston në gjykatën themelore në Prishtinë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Departamentet e Gjykatës së Apelit kanë juridiksion për tërë territorin e Kosovës. Gjykata Supreme është instanca gjyqësore më e lartë në Kosovë. Ajo përfshin kolegjin e apelit të Agjencia Kosovare e Pronës si dhe dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme. Pavarësisht nga lloji dhe numri i gjykatave, organizimi i tyre është rregulluar në bazë të parimit të gjyqësisë së unifikuar, ashtu që në gjykatë të njëjtë gjykohen çështjet penale dhe ato civile. Për punën e gjykatave kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit, me ç'rast jepen propozime për pengimin e dukurive shoqërore të rrezikshme dhe të dëmshme dhe për përforcimin e ligjshmërisë. Në realizimin e funksionit të gjykimit të çështjeve penale, gjykata vepron në përbërje individuale dhe kolegjiale. Në përbërje kolegjiale gjykata penale vendos një kolegji shqyrtues (prej tre gjyqtarësh profesionalë), i cili vendos jashtë shqyrtimit gjyqësor dhe në trup gjykues, që gjithashtu përbëhet prej tre gjyqtarëve profesionalë, por vendos në shqyrtim gjyqësor. (Ejup Sahiti)

GJYSHINCA I. Shefki (1932-2013). Gazetar. Lindi në Vushtrri, ku kreu edhe shkollën fillore. Shkollën normale e mbaroi në Pejë më 1950. Ndërkohë u emërua mësues në fshatin Siboc i Epërm të Podujevës, pastaj u transferua në Vushtrri. Punoi 15 vjet në shkollën fillore dhe në shkollën e natës (shkollën zejtare) në qytetin e lindjes, ndërsa një mandat katërvjeçar ishte drejtor i shkollës fillore "Boris Kidriç". Gjatë atyre viteve, për 30 vjet me radhë, raportoi për zhvillimet në Vushtrri për Radio Prishtinën, ndërsa 15 vjet për të përditshmen "Rilindja". Bashkëpunoi edhe me periodikun tjetër shqip të Kosovës, me "Zërin e rinisë", "Gazetën e pionierëve" etj. (Zenun Çelaj)

GJYTETI I RASHANIT. Kështjellë e periudhës së hershme bizantine, e ndërtuar gjatë shek. IV-V, rreth 5 km larg nga Mitrovica. Në dokumente ndeshet si Kështjella e Trepçës. Ka pozitë të favorshme gjeografike dhe, me një lartësi 851 m, ishte pararojë e burimeve minerare të Trepçës, si dhe kontrollonte rrugën kryesore që shkonte nga Municipiumi DD për Zveçan, Trepçë dhe Llap, si dhe rrugën tjetër Trepçë-Vicianum-Novobërdë. Gërmadhat e kështjellës "Gjyteti" gjenden në një kodrinë të rrëpirët, prej nga vështrimi rreth e përqark është gjithëpërfshirës. Nga kështjella shihet pothuajse i gjithë Rrafshi i Kosovës. Në shek. XIX arkeologu bitanik, Artur Evans, e përmend Municipiumin DD, si dhe një kala të quajtur sipas tregtarëve raguzanë "Montagna dell' Argento" ("Monte Argentaro"), ndërsa në të ashtuquajturën "Tabula Peutingeriana" përmendet "Argentaria". Në bazë të materialit të ndërtimit, kështjella i përket arkitekturës mesjetare, ndonëse objektet e luajtshme arkeologjike flasin për një vendbanim shumështrësor. Trashësia e murit rrethues të kështjellës është rreth 2 m, ndërsa lartësia e mureve të ruajtura deri më sot është 2-3 m. Kështjella është e vendosur në majë të një shkëmbi, lartësia e të cilit nga toka sillet nga 80 deri në 100 m. Ana veriore dhe lindore e kështjellës kanë mbrojtje natyrore, ndërsa ana perëndimore dhe jugore janë të mbrojtura me mure. (Pajazit Hajzeri)

GJYTETI. Toponim i ruajtur kryesisht për emërtimin e vendbanimeve të fortifikuara kodrinore. Lokalitetet arkeologjike me këtë toponim i takojnë antikës së vonë dhe mesjetës, për dallim nga vendbanimet e para kodrinore të epokës së eneolitit të njohur me emrin "Gradina". Në këto të fundit mund të ketë dhe shtresime të epokave vijuese, ndërsa ato të mesjetës së mesme e më pas njihen me toponimin "Kala". (Haxhi Mehmetaj)

H

HADËRGJONAJ Fadil (1966-) Ushtarak, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Sllup të Deçanit. Kreu Akademinë Ushtarake në Rajllonc të Bosnjës dhe në Zarë të Kroacisë. Deri në fillimin e zhbërjes së ish-Jugosllavisë ushtroi detyra të ndryshme ushtarake. Më pas emigroi në Gjermani. Në maj të vitit 1998 shkoi në veri të Shqipërisë (Tropojë), ku u angazhua në mobilizimin dhe ngritjen e formacionit të parë të Brigadës 134 dhe u emërua komandant i batalionit të tretë të kësaj brigade. Në qershor të vitit 1998, së bashku me shumë oficerë të tjerë dhe me njësitë e ngritura u fut në Kosovë. U dislokua në fshatin Jasiq e më pas në Prapaçan. U angazhua në beteja në Rrafshin e Dukagjinit, përfshirë edhe betejen e Loxhës më 7 korrik 1998, ku njësi i tij fitoi mbi forcat e armikut. Krahas detyrës së komandantit të batalionit, ushtroi edhe detyrën e shefit të shtabit të Brigadës 134. Në shtator 1998 u përfshi në përgatitjet për heqjen e kufirit me luftë, në operacionin e Koshares, dhe ishte udhëheqës i drejtimin operativ “Rrasa e Koshares”. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Ali Uka)

HADRI Abdullah (1887-1951). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, kreu Medresenë e Madhe në Gjakovë dhe në vitin 1905 u regjistrua në Fakultetin Pedagogjik në Stamboll. Ishte pjesëmarrës aktiv në lëvizjen kombëtare shqiptare. Në vitin 1912 hapi shkollën shqipe në mejtepin e xhamisë së Mahmud Pashës në Gjakovë. Në vitin 1914 ishte mësues në Petrelë, afër Tiranës. Gjatë Luftës së Parë Botërore hapi shkollën e parë shqipe në Vushtrri. Nga viti 1918-1936 ishte mësimdhënës në Medresenë e Madhe në Gjakovë, pastaj mësues në shkollën fillore “Sylejman Vokshi” po në Gjakovë (1943-

1945). Pas Luftës së Dytë Botërore ishte mësues dhe drejtor shkolle në Gjakovë. (Valentina Nimonaj-Hoti)

HADRI Ali (1928-1987). Historian, profesor, akademik. Lindi në Fier-Shegan të Lushnjës në një familje të shpërngulur nga Peja. Shkollën e mesme e kreu në Gjakovë, ndërsa studimet për



ALI HADRI

histori i kreu në Fakultetin Filozofik të Beogradit (1956). Mbrojti doktoratën në Universitetin e Prishtinës (UP) në vitin 1970. Ishte profesor ordinar i UP-së, dekan i Fakultetit Filozofik të UP-së, kryeredaktor i revistave “Përparimi”, “Gjurmime Albanologjike” (seria historike) dhe i revistës “Kosova” të Institutit të Historisë. Ishte drejtori i parë i Institutit të Historisë së Kosovës ndër anëtarët themelues të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (1975). Ishte delegat në Kuvendin Krahinor, kryetar i Lidhjes së Historianëve të Jugosllavisë, anëtar i shumë redaksive dhe forumeve profesionale të historianëve të ish-Jugosllavisë. Është autor i disa monografive shkencore, studimeve të veçanta dhe teksteve shkollore të historisë së popullit shqiptar, ndër të cilat: “Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare” (bashkautor Milan Perkaj, 1960), “Krahina Autonome e Kosovës” (bashkautor Dushan Pejanoviç, 1967), “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe epoka e tij” (1968), “Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945” (1971), “Kritikë historio-grafike I” (1973), “Gjakova në Lëvizjen Nacionalçlirimtare” (1974), “Ali Kelmendi (1900-1939)” (1984), dhe vepra e botuar pas vdekjes “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave” (2003).

Shumica e këtyre monografive janë botuar edhe në gjuhën serbokroate. A. Hadri shkroi edhe një sërë artikujsh për probleme të historisë bashkëkohore të popullit shqiptar, të historisë së Kosovës midis dy luftërave botërore, të historisë së Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) të Kosovës dhe të Shqipërisë dhe zhvilloi polemika shkencore me historianë serbë dhe jugosllavë rreth historisë së re të popullit shqiptar, veçmas rreth LANÇ-së në Kosovë dhe në Shqipëri. Pas demonstratave të vitit 1981 u shkarkua nga detyra e drejtorit të Institutit të Historisë, u përjashtua nga puna në Universitetin e Prishtinës dhe u akuzua si nacionalist nga autoritetet e pushtetit. (Jusuf Bajraktari)

HADRI Enver (1941-1990). Veprimtar i mërgatës së Kosovës në Perëndim. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë. Studioi arkitekturën në Beograd dhe Lubjanë.



ENVER HADRI

Pas disa arrestimeve, më 1972 arratiset në Belgjikë, ku mori statusin e refugjatit politik. Atje zhvilloi aktivitet politik në kuadër të organizatës “Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës”. Organizata kishte organin e saj “Zëri i Kosovës” në gjuhën shqipe dhe frënge, përmes të cilit bëhej thirrje për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. E. Hadri u angazhua për koordinimin e veprimeve të mërgatës shqiptare në Perëndim mes rrymave të majta dhe të djathta. Ishte ndër të parët që arriti ta paraqesë çështjen e Kosovës në qarqet politike të disa vendeve të Bashkimit Europian. Ai denoncoi politikën e dhunës që ushtrohej në Kosovë, në opinionin publik dhe tek institucionet ndërkombëtare. Për këtë qëllim, në Bruksel formoi dhe drejtoi Komitetin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë. U vra në Bruksel në një atentat të organizuar nga shërbimit sekret i Serbisë, ndërsa kishte me vete listën e 32 shqiptarëve të vrarë nga Serbia në Kosovë, të cilën do t’ia dorëzonte të nesërmen Komisionit të të Drejtave të Njeriut në Parlamentin Europian. (Muhamet Shatri)

HADRI Flamur (1955-1999). Historian, dramaturg. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, studimet

për histori i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës. Punoi në degën e historisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në këtë institut botoi librat studimorë: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe epoka e tij në historiografinë shqiptare” (1987), “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” (1995) dhe “Skënderbeu në historiografinë europiane” (1998). Njihet edhe si autor dramash. Botoi dramën “Mesjeta” (1985), e cila mori çmim në konkursin për dramë origjinale “Katarina Josipi” të Teatrit Popullor Krahinor. Më pas botoi dramën “Sundimtarët” (1985), si dhe romanin “Përballë jetës” (1990). La në dorëshkrim edhe disa drama dhe studime historike për Skënderbeun. Vdiq në një aksident komunikacioni në Prishtinë. (Naime Beqiraj)

HAGADA. Lloj letrar moralizues fetar (nga hebraishtja Haggada), këngë që këndohet në shërbesat kishtarë të pashkëve dhe u kushtojë 12 shenjtorëve. Si këngë ka kaluar edhe në traditën gojore, ku 12 numrat përfaqësojnë po aq të vërteta absolute. Në traditën shqiptare është bërë këngë argëtuese-shpotitëse, në të cilën për çdo numër thuhet nga një e vërtetë e pakontestueshme. Struktura e këngës përbëhet nga 12 përgjigje të pyetjeve që nënkuptohen vetvetiu. Këngët e këtilla këndohen në mënyrë të veçantë nga dy grupe: një numër e thotë grupi i parë, numrin vijues grupi i dytë, me ç’rast, krahas numrave vijues, përsëriten të gjitha konstatimet për numrat e mëparshëm. Kënga përbëhet nga 12 strofa: strofa e parë i ka tri vargje, e në vazhdim numri i vargjeve shtohet për nga një dhe në strofën e fundit arrin në pesëmbëdhjetë vargje: *e ka vasha ni bylbyl// bylbyli knon malit//sall për hatër të djalit - ...ke ni na u bënë dy - dy lula na i ka vasha... tri komë perushlija*, dhe kështu deri në numrin e fundit të dymbëdhjetin: *dymdhetë mujë i ka motmoti*. Mbledhësi i parë i hagadave në folkloristikën shqiptare është etnomuzikologu Lorenc Antoni, në serinë e botimeve të tij “Folklor muzikor shqiptar”. Hagada ka mbledhur edhe etnologu Kadri Halimi, i cili ka bërë studimin e parë për to (1959). (Sadri Fetiu)

HAJDARAJ Adem (1944-2014). Albanolog, politikan. Lindi në Dugaijë të Rugovës, komuna e Pejës. Shkollën fillore dhe të mesme

i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe në Prishtinë. U gradua doktor i shkencave filologjike në Universitetin e Tetovës, me temë për të folmen e Rugovës. Monografinë “E folmja e Rugovës: fonetika, morfologjia, sintaksa” e publikoi më 1996. Ishte veprimtar për pajtimin e gjaqeve dhe aktivist i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës. Punoi si mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Botoi artikuj të ndryshëm studimorë. (Agnesa Hasimja)

HAJDARAJ Rexhep (1962-1999). Mjek i përgjithshëm, dëshmor. Lindi në fshatin Shaptej, Deçan. Shkollën fillore e kreu në fshatin Gramaçel, ndërsa të mesmen në Deçan. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Si student ishte pjesëmarrës i lëvizjes studentore në vitet 1981-1989. Pas diplomimit filloi punën në shoqatën humanitare “Nënë Tereza” në Deçan, ndërsa më vonë punoi si mjek në shkollën fillore “Drita” në fshatin Gramaçel. Nga fillimi i luftës në Rrafshin e Dukagjinit ishte ndër mjekët e parë, i cili iu bashkua radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku dha një kontribut të veçantë si në radhët e UÇK-së, ashtu edhe në ndihmë popullatës civile të Rrafshit të Dukagjinit. Më 27 prill 1999 u vra në një pritë të forcave ushtarake dhe paramilitare serbe në hyrje të fshatit Sheremetaj. (Haki Shehu)

HAJDARI Arben (1981-). Arkeolog, historian. Lindi në Bardhaniq, komuna e Gjakovës. Arsimin fillor e kreu në Ratishë, kurse atë të mesmin në Irzniq. Kreu studimet për histori në Universitetin e Prishtinës (UP), kurse magjistroi për arkeologji në Universitetin “Pjer Mendes France”, në Grenoble 2 në Francë (2006). U doktorua me temën “Ulpiana dhe romanizimi i Dardanisë” në po të njëjtin universitet në fushën e historisë antike dhe të arkeologjisë (2013). Ka marrë pjesë në shumë simpoziume dhe kongrese shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është bashkautorë i monografisë “Kalaja e Harilaqit” (2012), si dhe i një numër studimesh shkencore të botuara në organe dhe revista të ndryshme shkencore, vendore dhe ndërkombëtare. Në periudhën 2002-2013 mori pjesë në disa ekspedita të kërkimeve arkeologjike në Kosovë dhe jashtë saj. Është mësimdhënës në departamentin e

historisë dhe të antropologjisë/arkeologjisë në Fakultetin Filozofik të UP-së. (Pleurat Kabashi)

HAJDARI Fazli (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB). Lindi në Vranjë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Preshevë. Në vitin 1993 ra në kontakt me veprimtarët e Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe më pas u bë aktivist i saj. Më 1997 u emërua zëvendëskomandant i Batalionit Mbështetës të UÇK-së dhe udhëhoqi njësitet ushtarake në vijën e furnizimit Llojan-Preshevë-Kosovë. Me fillimin e luftës së UÇPMB-së u angazhua për organizimin dhe masivizimin e saj. Ishte shef i logjistikës në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së. (Fehari Ramadani)

HAJDARI Haki (1963-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Klinë të Ulët, komuna e Skënderajt. Sa ishte në shërbim ushtarak, u dënua me burg për arsye politike. Ishte anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe më pas njëri ndër pjesëtarët e grupeve të para të armatosura në Kosovë. Aksionin e parë ndaj forcave serbe e ndërmori në maj të vitit 1992, afër Fabrikës së municionit në Skënderaj. Në vitin 1992 në mungesë u dënua me 9 vjet burg nga Gjykata serbe e Prishtinës. Më 6 gusht 1992 kaloi në Shqipëri, ku zhvilloi takimet me veprimtarë kryesorë të lëvizjes guerile dhe më 1993 u vendos në Krumë, nga do të koordinojë aktivitetet ushtarake. Me fillimin e luftës, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e emëroi përgjegjës kryesor për armatim në zonën e Veriut. U bë përgjegjësi kryesor për kalimin Has-Kukës të kufirit Shqipëri-Kosovë, ku kishte rol të veçantë edhe për kalimin e armatimit për nevojat e UÇK-së. Me përfundimin e luftës një kohë ishte i angazhuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. (Sabit Sylja)

HAJDARI Lirie (1978-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Prishtinë. Studimet i vazhdoi në Fakultetin e Filologjisë, dega letërsi shqipe në Prishtinë. Me gazetari filloi të merret menjëherë pas përfundimit të luftës, më 1999. Fillimisht punoi në gazetën “Dardania”. Në janar të vitit 2000 nisi punën në gazetën e përditshme “Bota sot”, si gazetare, për të kaluar në pozitën e redaktore nga viti 2009 deri më dhjetor të 2013.

Në shkurt të vitit 2014 nisi punën e gazetares dhe të redaktores në gazetën e përditshme dhe portalin “Botapress”. (Bajrush Morina)

HAJDINI Zenel (1910-1942). Pjesëmarrës i LNÇ-së, Hero i Popullit. Lindi në fshatin Tupallë të Medvegjës. Shkollën fillore e kreu në Medvegjë dhe më pas vazhdoi Medresenë “Kral Aleksandri I” në Shkup. Aty u pranua në radhët e rinisë komuniste të Jugosllavisë (1934) dhe u zgjodh kryetar i organizatës së rinisë komuniste në medrese. Studimet për matematikë i regjistroi në Universitetin e Beogradit (1936). Gjatë studimeve, më 1938, u pranua në Partinë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Ai ishte i interesuar që të krijonte lidhje edhe me Shqipërinë dhe kishte kontakte me ambasadorin e Shqipërisë në Beograd. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga Gjermania u kthye në fshatin e lindjes dhe iu bashkua organizatës së PKJ-së në Leskovc. Pas formimit të aradheve partizane të Kukavicës dhe të Jabllanicës së Epërme, u caktua anëtar i shtabit të këtyre aradheve. Në përbashkëti me një njësit çetnik në Gazdarski Rid u vra. Në shenjë nderimi, aradhja e parë partizane e Kosovës, që u formua në Ramjan afër Vitisë u emërtuan me emrin e tij. Në vitin 1953 u shpall Hero i Popullit. (Fehmi Pushkolli)

HAJREDINAJ Arbana (1970-). Piktore, gazetare. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për matematikë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe drejtimin për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2002). Punon si gazetare në Radiotelevizionin e Kosovës dhe është autore e emisionit për artin pamor. Hapi disa ekspozita personale: “Atje nis”, videoinstalacion në Galerinë e Arteve të Kosovës me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (2008); “Homazh për babanë”, videoinstalacion në Galerinë e Ministrisë së Kulturës po në Prishtinë (2005) dhe më parë “Femrat nga Marsi”, Galeria e Arteve “Vizioni 2000” në Gjakovë; “Asgjë nuk është e përsosur” gjithashtu videoinstalacion (2002) në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë; “Fundi i ditëve dhe një fillim i ri”, performancë në Institutin Albanologjik të Prishtinës etj. (Ilir Muharremi)

HAJREDINAJ Jakup (1939-1994). Pikturor. Lindi në Stanoc të Epërm të Vushtrrisë. Kreu

shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje dhe në Prishtinë. Fakultetin e Arteve e kreu po ashtu në Prishtinë. Në fillim punoi si mësues në disa fshatra të Kaçanikut, më pas në Magurë të Lipjanit, në shkollën fillore “Zejnel Hajdini” në Prishtinë e më vonë në gjimnazin “Skënderbeu” në Drenas. Disa vjet punoi në shkollat fillore “Faik Konica” dhe “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Krijimtaria e tij dallohet për shprehjen surrealistike. Mori çmime dhe mirënjohje për punë të suksesshme në fushën e pikturës: në vitin 1982 çmimin e parë për pikturë nga Shoqatat e Artistëve Figurativë të Kosovës, në vitin 1993 në ekspozitën “Shpërngulja plagë shekullore” mori gjithashtu çmimin e parë për pikturë. (Bislim Aliu)

HAJREDINI Driton (1970-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2003). U diplomua në Akademinë e Arteve në Mynster të Gjermanisë më 2006. Ekspozitat më të rëndësishme vetjake dhe të përbashkëta: në Bremen e Berlin (Gjermani), Beograd, Prishtinë, Vjenë, Lisbonë, Paris, Sarajevë, Boston e Hjuston (SHBA), Stamboll, Amsterdam, Budapest dhe në Qipro. U shpërblye në Video Festivalin në Prishtinë, pastaj në Budapest, në Vjenë, në Rejkjavik etj. Është nga krijuesit e rinj më të talentuar dhe më të afirmuar të ne. Shquhet veçanërisht midis krijuesve konceptualistë të gjeneratës së tij në vend dhe jashtë. (Tahir Emra)

HAJRIZI Fazli (1949-). Mësimdhënës dhe studiues. Lindi në fshatin Kotorr, Skënderaj. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Runikë, gjimnazin në Mitrovicë, studimet e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte mësimdhënës në gjimnazin e Skënderajt dhe të Vitisë, në shkollën teknike, në Qendrën shkollore dhe në gjimnazin e Mitrovicës, ku kreu edhe detyrën e drejtorit të kësaj shkolle. Si bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik mori pjesë në disa konferenca shkencore për letërsinë, folklorin, historinë, arsimin. Është autor veprash letrare dhe monografish për shkolla dhe personalitete të shquara të arsimit dhe të lëvizjes kombëtare: “Gjimnazi i Mitrovicës 1946-2000” (2000), “Shkolla normale ‘Hasan Prishtina’ e Mitrovicës 1967-1977” (2007),

“Rexhep Mitrovica në Lëvizjen Kombëtare” (2008), “Bedri Gjinaj-mësues dhe patriot i shquar” (2014), “Shkolla teknike në Mitrovicë 1946-2014” (2014) etj. (Bajram Shatri)

HAJRIZI Mehmet (1948-). Veprimtar politik, publicist. Lindi në Strofc të Vushtrrisë. Shkollën Normale dhe Fakultetin Filozofik i kreu në Prishtinë. Ishte udhëheqës i Organizatës



MEHMET HAJRIZI

Marksiste-Leniniste të Kosovës, e cila ishte organizata më e madhe e kësaj lëvizjeje gjatë viteve '70 në Kosovë. Ka qenë bashkëthemelues dhe kryeredaktor i organeve të shtypit klandestin, “Zëri i Kosovës”, “Pararoja” dhe “Liria”. Më 1981, pas demonstratave, u arrestua dhe u dënua me 12 vjet burg. Pas daljes nga burgu u angazhua në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), si anëtar i Këshillit Drejtues dhe më pas anëtar i kryesisë. Ndërkohë mbante lidhje dhe e ndihmonte edhe lëvizjen ilegale. Më 1992 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës në zgjedhjet e organizuara nga LDK-ja. Drejtoi për disa vjet Këshillin Qendror të Financimit të formuar më 1992. Në mars të vitit 1998 ishte njëri nga themeluesit dhe sekretar i përgjithshëm i Lëvizjes Demokratike Shqiptare dhe më vonë i Lëvizjes së Bashkuar Demokratike. Në shkurt-mars 1999 në Konferencën e Rambujesë ishte anëtar i delegacionit të Kosovës, ndërsa në prill të po atij viti u emërua zëvendëskryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, e cila u formua sipas marrëveshjes së delegacionit kosovar në Rambuje. Më pas kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e Kosovës. Ka botuar disa libra: “Sprova të çlirimit” (2004), “Histori e një organizate politike dhe demonstratave të vitit 1981” (2008), “Nga grupi revolucionar te fronti i Republikës” (2014) etj. (Ruzhdi Jashari)

HAJRULLAHU Arben (1975-). Politolog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Prishtinë, studioi shkencat politike në Universitetin e Prishtinës (UP), më pastaj në Grac, Vjenë dhe Hudërsfeld. Ka publikuar një numër studimesh për vendet e Ballkanit Perëndimor. Teza e tij e doktoratës mbi “Integrimin në BE dhe krijimin e paqes afatgjate në Ballkanin Perëndimor” fitoi çmimin për vepër shkencore të vitit 2005



ARBEN
HAJRULLAHU

nga Fondacioni Euro-pian “Dr. Alois Mok”, e publikuar më 2007 në Gjermani. Që nga 2001, A. Hajrullahu ishte bashkëpunëtor shkencor në Qendrën për Europën Juglindore, në kuadër të Karl-Franzens-it të Universitetit të Gracit, kurse prej 2003 deri më 2005 punoi si bashkëpunëtor shkencor në kuadër të Institutit Austriak për Politikë të Jashtme në Vjenë. Në periudhën 2007-2011 ishte bashkëpunëtor shkencor në kuadër të Akademisë Europiane “Bolzano”. Është autor i librit “Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet integritimit në Unionin Europian”. Është mësimdhënës në departamentin e shkencave politike të Fakultetit Filozofik të UP-së dhe ligjëron për politikën botërore, partitë politike, zgjedhjet dhe demokracinë etj. (Adem Beha)

HAJRULLAHU Artan (1979-). Pikturor. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në Prilepnicë, të mesmen në Gjilan, ndërsa Fakultetin e Arteve, dega e pikturës, në Prishtinë (2004). Në vitin 2006 hapi ekspozitën e parë vetjake në Galerinë e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë dhe më pas ekspozoi në Galerinë e Arteve të Kosovës (2010) dhe mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta: “Portreti” (Gjilan, 2003), Salloni i Nëntorit (Prishtinë, 2003), Salloni II Vjeshtor (Gjilan, 2007), Salloni i Nëntorit (Shkup dhe Gostivar, 2008 dhe 2009). Fitoi disa çmime, si çmimin e parë për pikturë në “Flaka e Janarit” 2006, në Salloni Vjeshtor 2007, nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Gjilanit më 2009 dhe çmimin “Artistët e së nesërme” më 2013. (Ilir Muharremi)

HAJRULLAHU Idriz (Mulla Idrizi) (1901-1949). Njëri ndër organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të rezistencës kundër rivendosijes së pushtetit jugosllav në Kosovë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore. Lindi në fshatin Velekincë të Gjilanit. Mejtepin e kreu në Cernicë, ruzhdijen në Gjilan më 1926. Ishte imam në Pidiq të Karadakut, pastaj në Hogosht deri më 1938, kur u zgjodh kryeimam në Gjilan. U mor edhe me shkrime teorike për probleme të fesë dhe të filozofisë islame, që i botoi në revistat e atëherëshme fetare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore



IDRIZ
HAJRULLAHU

shërbeu në Gjilan. Në verë të vitit 1944 u vu në krye të forcave vullnetare që mbrojnë vijën e kufirit nga sulmet dhe depërtimet në Kosovë të njësiteve partizane jugosllave. Në periudhën qershor-shtator 1944 luftoi kundër njësiteve par-

tizane serbe, bullgare e maqedonase në Veleglavë, Kikë, Bujanoc dhe Preshevë. Edhe më pas vazhdoi rezistencën kundër pushtetit komunist që po vendosej në Kosovë. U zgjodh komandant i Shtabit të Rezistencës, ku bënë pjesë edhe Muharrem Fejza, Sylë Zarbinca, Shefki Ajdini dhe Shyt Mareci, anëtarë. Forcat vullnetare të Rezistencës më 23 dhjetor 1944 sulmuan Gjilanin nga të katër anët dhe çliruan një pjesë të qytetit. Për shkak të përforsimeve që i erdhën ushtrisë jugosllave nga Prishtina e Ferizaj, vullnetarët u tërhoqën nga qyteti. Pas këtij aksioni, I. Hajrullahu me anëtarët e Shtabit të Rezistencës kaloi në ilegalitet. U strehua në Gjyrishec deri në vitin 1949 kur OZN-a i ra në gjurmë dhe e arrestoi. Supozohet se e dogjën me benzinë në burgun e Gjilanit. (Fehmi Rexhepi)

HAJRULLAHU Muhamet (1980-). Gazetar. Lindi në Medvegjë, ku përfundoi shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e mbaroi në Preshevë. Mbaroi studimet universitare për gazetari dhe bëri specializim në Britani të Madhe po në këtë fushë. Një kohë punoi në Televizionin "Kohavision", ku raportoi për ngjarje të rëndësishme politike, përfshirë edhe bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Vjenë në vitin 2007 për statusin e Kosovës. Më pas u bë udhëheqës i diskut planifikues në Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe është redaktor i emisionit "Jeta në Kosovë". Njëkohësisht është përgjegjës për raportimin e rasteve në platformën "Kallxo.com". (Ibrahim Berisha)

HAJVALIA. Fshat në komunën e Prishtinës, rreth 5 km në jug të qytetit. Është vendbanim i tipit të grumbulluar. Vendbanimin e themeluan disa familje çerkeze në vitin 1862, të cilët i kishte vendosur aty pushteti osman. Këto familje (rreth 40 sosh) pas luftës së vitit 1877/78 u shpërngulën për në Turqi. Në pronat e tyre vendosen familjet e muhaxhirëve të dëbuar nga sanxhaku i Nishit. Në dokumentet

e shkruara përmendet në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1885/56. Si vendbanim me dy emra Adlije dhe Ajvali është i regjistruar edhe në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893, 1989 dhe 1900. Deri në fund të shekullit XIX, vendbanimi kishte 100 familje shqiptare, ndërsa në vitin 1905 kishte 150 sosh. Pas vitit 1912 fillon shpërngulja e popullsisë shqiptare. Sipas regjistrimit të vitit 1913 fshati kishte 491 banorë shqiptarë, ndërsa sipas A. Urosheviq, në vitin 1913 në këtë fshat jetonin rreth 80 familje muhaxhire, shumica e të cilëve më pas u shpërngulën për në Turqi. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për shkak të pozitës dhe afërsisë ndaj qytetit të Prishtinës, këtu vendosen një numër i shqiptarëve nga viset e ndryshme të Kosovës. Në vitin 1948 kishte 79 shtëpi me 436 banorë, në vitin 1981 kishte 437 shtëpi me 3,033 banorë, ndërsa sipas vlerësimeve në vitin 1999 fshati kishte 966 shtëpi me rreth 3,700 banorë. Në aspektin fizionomik dhe funksional, Hajvalia tashmë bën pjesë në zonën periurbane të Prishtinës. (Nazif Gashi)

HAKAJ Lindita (1982-). Soprano. Lindi në Mitrovicë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. Si 16-vjeçare u regjistrua në Fakultetin e Arteve, drejtimi i solokëndimit dhe u diplomua më 2004 me rolin e Karmenit të operës së G. Bizet, inskenimi i parë operistik nga Filarmonia-Opera e Kosovës. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Shkupit, gjatë të cilave mori dhe rol në Teatrin e Operës së Shkupit. Përveç Karmenit interpretoi rolin e Mercedesit në Teatrin e Operës së Shkupit, Hareza në "Dasma arbreshe" të R. Dhomit, "Missa Criola" të A. Ramirez-it, soliste me kor e orkestër "Stabat Mater" të Pergolesit, Amneris në operën "Aida". Si soliste koncertoi në Paris, Grac, Tiranë, Zagreb (me Ansamblin "M"), dha në koncerte solistike me arie kompozitorësh shqiptarë në Londër e Dyseldorf. Ishte soliste në Filarmoninë e Kosovës (2001-2012), mësimdhënëse në Shkollën e Mesme të Muzikës në Mitrovicë. Nga viti 2010 është profesore e solokëndimit në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë, anëtare e grupit "Ars Nova" (2005-2009), e korit "New Born", e oktetit "M" dhe pjesëmarrëse në festivalet e organizuara në Kosovë. (Indira Çipa)

HAKAJ Ymer (1945-2007). Inxhinier i xehtarisë. Lindi në fshatin Klinë e Epërme të

Skënderajt. Shkollën fillore, atë të mesme dhe Shkollën e Lartë Teknike i kreu në Mitrovicë. Studimet i mbaroi në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universiteti të Beogradit (1971). Pas përfundimit të studimeve në Beograd punoi në minierën e Stantërgut, më pas u zgjodh drejtor teknik i flotacionit në Zveçan. Në vitin 1978 kalon në minierat Kishnicë e Novobërdë, ku për vite të tëra kreu një varg funksionesh drejtuese. Për një kohë të gjatë ishte asistent dhe asistent i autorizuar për lëndën transporti në miniera në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm. (Shyqeri Kelmendi)

HAKMARRJA. Shpëtim për një të keqe, për një dhunë, për një vepër penale apo për një veprim të konsideruar të padrejtë, duke e ndëshkuar në mënyra të ndryshme atë që e ka bërë. Hakmarrja është nocion më i gjerë se gjakmarrja, por është refleksi i zakonit të gjakmarrjes. Hakmarrja është relativisht më e përhapur se gjakmarrja, sidomos për larje hesapësh midis palëve të konfrontuara. Kanuni bën dallimin e qartë ndërmjet hakmarrjes dhe gjakmarrjes. Hakmarrja ndodhte atëherë, kur dikush dëmtohej nga një vjedhje. I dëmtuari kishte të drejtë për pronën e tij të vjedhur të kryente një hakmarrje, sipas parimit “vjedhje për vjedhje”. Ndërsa gjakmarrja ishte konsekuencë e një vrasjeje të mëhershme, ose e dhunimit të nderit. Duke qenë se dëshira për hakmarrje paraqet një rën nga ndjeshmëritë më universale dhe më të hershme, shoqëritë e ndryshme kanë krijuar zakone përkatëse, duke mos e lënë anash këtu as drejtësinë, në përpjekje për t'i evituar pasojat e padëshiruara, përfshirë edhe gjakmarrjen. Në shumë shtete hakmarrja zyrtarisht konsiderohet si veprim primitiv dhe i rrezikshëm për shoqërinë, ndaj edhe dënimet me motivacion të hakmarrjes janë më të rënda. Nxjerrja e hakut në ato shoqëri ka kaluar në kompetenca të organeve shtetërore të drejtësisë. (Bashkim Lajçi)

HALD Martin (Huld) (1952-). Gjuhëtar amerikan, albanist, profesor në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë. Doktoroi në UCLA më 1979 me temën “Glosar etimologjik i termave të zgjedhur të shqipes” (An etymological glossary of selected Albanian terms). Nisi të botojë për probleme të ndryshme të etimologjive shqipe qysh në pjesën e dytë të viteve '70 të she. XX.

Botoi studime të veçanta etimologjike për fjalë themelore të shqipes, si: *yll, i thellë, ju, vjerr, zverk, sy*. Shkroi për kompozitat e fjalëve për zogjtë e kafshët dhe peshqit në gjuhën shqipe, për theksin indoeuropian të shqipes si dhe për shtresimin theksor të huazimeve të vjetra greke të shqipes. Një nga veprat më të rëndësishme të tij është “Etiomlogji themelore të shqipes” (Basic Albanian etymologies), botuar më 1984. (Imri Badallaj)

HALILAJ Petrit (1986-). Artist bashkëkohor. Lindi në Kostërc të Skënderajt. Kreu studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Brera të Milanos. Praktika e tij artistike është ndërtuar rreth biografisë së tij dhe kushteve të jetës nëpërmjet medimeve të ndryshme, materiale, nga jeta e përditshme (instalacion, video, skulptura, vizatim, piktura). Ka mbajtur disa ekspozita personale në Kosovë dhe jashtë vendit (Milano, Paris, Berlin, Prishtinë, Lisbon, Bruksel, St. Gallen, Innsbruck) (2009-2015) dhe në shumë ekspozita kolektive (Bedburg-Hau, Nurnberg, Romë, Bon, Muhldorf, Arnsberg, Stamboll) (2008-2013). Në vitin 2013 përfaqësoi Kosovën në Bienalen e 55-të të Venecias. Është fitues i disa çmimeve dhe pjesëmarrës në rezidenca artistike (2014, Villa Romana, Firence, 2010, Blau Oranga). (Zeni Balazhi)

HALILI Emin (1952-). Regjisor filmi dhe televizioni, mësimdhënës universiteti. Lindi në Millë të Ulqinit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Ulqin. Studimet për regji të filmit dhe të televizionit i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Beogradit. Është mësimdhënës i lëndës regji filmi dhe shef i kësaj dege në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punoi në Televizionin e Prishtinës, ndërsa pas largimit të punonjësve shqiptarë nga ky institucion më 1990 kthehet në Ulqin dhe deri në vitin 2000 punoi në Qendrën e Kulturës, një kohë si menaxher dhe drejtor i saj. Në llojin e filmit të shkurtër bëri regjinë e filmave: “Dum Sharaveli”, “Festa”, “Dritarja”, “Vrasja e dytë”, ndërsa nga filmat televizivë bëri regjinë e filmave: “Nën qarr po rrinte vasha”, “Fluturimi i Micakut” dhe “Deti



EMIN HALILI

në këngë”. Është autor i filmave dokumentarë: “Fëmijët e rrugës së Zveçanit”, “Miqësia në horizontin 11”, “Femrat e burgosura në burgun e Lipjanit”, “Shqiptarët etnikë në mal të Zi”. Filmi i parë artistik në 35 mm është “Pikniku”, ku e bëri regjinë, sipas skenarit të Atdhe Gashit, ndërsa u shfaq në Festivalin e Pulës. Realizoi edhe filmin artistik “Era e mollës”. (Gani Mehmetaj)

HALILI Fetah (1949-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Gaçkë të Ferizajt ku kreu shkollën fillore, të mesmen e filloi në Shkup dhe e përfundoi në Ferizaj (1971). Kreu studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN), dega e biologjisë, në Universitetin e Prishtinës (1974). Magjistroi në Universitetin e Zagrebit dhe tezën e doktoratës e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1985). Në vitin 1975 filloi punë asistent në FSHMN, ku në vitet vijuese gradohet në të gjithë titujt universitarë. Kreu detyra të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë Universitetin e Prishtinës dhe Ministrinë e Arsimit, si dhe ka qenë koordinator apo bashkëkoordinator në disa projekte të financuara nga Konferenca e Rektorëve Gjermanë dhe WUS Austria. Ka kontribuar në hartimin e dy dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës: “Programi kombëtar i shkencës” dhe “Strategjia për mjedisin në Kosovë” (2010-2016). Ka publikuar punime shkencore, tekste shkollore dhe universitare. (Behxhet Mustafa)

HALILI Llukman (1956-). Gazetar. Lindi në Tërrnoc të Madh. Shkollën fillore e kreu në Tërrnoc, ndërsa gjimnazin në Bujanoc. Në vitin 1979 u diplomua në Fakultetin e Shkencave Politike në Zagreb, ku mbaroi edhe studimet pasuniversitare nga lëmi i marrëdhënieve ndërkombëtare. Nga viti 1983 e deri më 1985 qëndron në Poloni, ku u specializua në lëmin historisë politike të shteteve të Lindjes. Në vitet 1985-1990 ishte komentator në redaksinë e politikës së jashtme në Radiotelevizionin e Prishtinës, pastaj korrespondent i agjencisë kroate të lajmeve “HINA” nga Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria. Si bashkautor, në vitin 1992 botoi librin “Unë Ramiz Alia, dëshmoj për historinë”, kurse më 2012 botoi librin në kroatishte “Politika e jashtme e Polonisë 1945-1980”. Nga viti 1994 punon në Zvicër, në disa

gazeta dhe media shqiptare. Në vitin 2013, në Universitetin e Zarës, mbrojti disertacionin me temë “Lëvizja e dhjetorit 1990 në Shqipëri”. Jeton në Zvicër. (Shefqet Rexhepi)

HALILI Muhamet (1972-). Gazetar i sportit. Lindi në Gjilan. Fillimisht merrej me enigmatikë. Një kohë ishte i angazhuar në disa gazeta dhe revista lokale, përgjegjës për rubrikën e sportit dhe të zbavitjes. Në periudhën 2000-2005 punoi në Radio-Gjilan, një kohë gazetar dhe më pas përgjegjës i sektorit të sportit. Paralelisht ishte edhe gazetar i Agjencisë së lajmeve “Kosovapress” (2000-2010), ku raportonte ngjarjet sportive nga Gjilani. Nga viti 2010 është themelues dhe drejtues i portalit të lajmeve rajonale “2Lonline”. (Enver Sadiku)

HALILI Nevzat (1946-). Politikan. Lindi në fshatin Poroj të Tetovës, diplomoi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Shkupit për gjuhë dhe letërsisë angleze. Ishte mësimdhënës



NEVZAT HALILI

në shkollën e mesme të mjekësisë në Tetovë. Në vitin 1990 u zgjodh kryetar i parë i Partisë për Prosperitetin Demokratik (PPD), partisë së parë postkomuniste shqiptare në Maqedoni. Si kryetar i PPD-së mori nismën për kontestimin dhe bojkotimin e referendumit për pavarësi të Maqedonisë (1991), si dhe votimin e Kushtetutës së Maqedonisë në kohën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Nën drejtimin e tij u organizua referendumi për autonomi politiko-territoriale të shqiptarëve të Maqedonisë (“Republika e Iliridës”). Nën drejtimin e tij PPD-ja fitoi 22 deputetë në Parlamentin e Maqedonisë dhe hyri në koalicion qeveritar me Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë. Pas Kongresit të partisë, kur PPD-ja u nda, N. Halili themeloi Partinë Republikane për Unitet Popullor (PRUP). Ishte ndër të parët që doli në mbrojtje të Universitetit të Tetovës, për çka u dënua me burg. Në vitin 2001 mbështeti luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe sërisht u dënua me burg. Më vonë e aktivizoi edhe idenë e tij për funksionalizimin e “Republikës së Iliridës”, duke u zgjedhur edhe kryetar i saj. (Arsim Sinani)

HALILI Ragip (1943-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Sallabajë të Podujevës. Shkollim fillor e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesëm dhe Fakultetin Juridik në Prishtinë.



RAGIP HALILI

Magjistroi në Universitetin e Beogradit, ndërsa doktoroi në Universitetin e Sarajevës. Filloi punë si asistent i lëndës kriminologji me penologji në Fakultetin Juridike të Universitetit të Prishtinës, duke marrë të gjithë titujt akademikë, deri te titulli profesor i rregullt. Ishte prodekan dhe dekan i Fakultetit Juridik, kryeredaktor i revistës “E drejta”. Kreu detyra të tjera në institucionet e arsimit të lartë dhe ushtri funksione politike dhe partiake në periudhën e autonomisë së Kosovës. Në periudhën 1991-1995 punoi avokat i licencuar, ndërsa gjatë vitit 1999-2000 ishte anëtar i Komisionit Këshillëdhënës Gjyqësor të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara për Kosovë. Ligjëroi edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Është autor i disa monografive dhe teksteve universitare: “Kriminologjia” (2000), “Penologjia” (2000), “Sanksionet penale sipas të drejtës zakonore në Kosovë” (1985) etj. (Ejup Sahiti)

HALILI Shqipe (1962-). Gazetare, moderatore. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Që kur ishte nxënëse e shkollës fillore kishte moderuar programe të fëmijëve në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), ku më pastaj vazhdoi karrierën si gazetare profesioniste. Në korrik të vitit 1990, pas masave të dhunshme të Serbisë, përjashtohet nga puna. Në vitin 2000 sërish i kthehet moderimit dhe gazetarisë në emisionet për fëmijë në RTK. U shqua me prezantimet në emisionet për fëmijë në RTP dhe në Radiotelevizionin e Kosovës, si: “Kuizi”, “Tash, fillo”, “Përrallat për fëmijë” etj. Është redaktore në redaksinë e programit shkollor në RTK-së. (Shaqir Foniqi)

HALILI Zejnullah (1945-2004). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Kokaj të Gjilanit. Kreu shkollën fillore në Llovcë dhe në Pogragjë, shkollën e mesme në Gjilan, kurse Shkollën e

Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues në fshatin Bilincë dhe në Gjilan, pastaj gazetar dhe redaktor në emisionet për fëmijë të Radio Prishtinës, redaktor e kryeredaktor i “Gazetës së pionierëve” dhe i revistës letrare “Pionieri”. Z. Halili njihet kryesisht si shkrimtar për fëmijë, poet e tregimtar. E njëjtte botën e fëmijëve, prandaj në krijimtarinë e tij letrare, sidomos në tregime, trajtohet fati i fëmijëve të kohës së fëmijërisë së tij, ashtu siç nuk ishte indiferent as ndaj gjendjes së vështirë të fëmijëve shqiptarë të Kosovës pas vitit 1990. Nga krijimtaria e tij buron dashuri e fuqishme jo vetëm për fëmijët, por për njeriun në përgjithësi. Veprat e botuara: “Ylberi” (1969), “Shitësja flokartë” (1971), “Ç’thonë pulëbardhat” (1973), “Eshkë e dritë” (1977), “Luleshqiponja” (1993), “Djaloshi brenda mollës” (1999), “Unazë” (2004) etj. (Arif Demolli)

HALILI Zeqir (1853-1918). Luftëtar i kryengritjeve antiosmane nga Malësia e Gjakovës. Lindi në Fang të Bujanit. Ishte pjesëmarrës aktiv në të gjitha lëvizjet për çlirim kombëtar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në fund të Luftës së Parë Botërore. U dallua posaçërisht në organizimin e Lidhjes së Pejës “Besa-Besë”, në kryengritjet antiosmane të viteve 1909-1912 në vilajetin e Kosovës. Më 1910, në bashkëpunim me Bajram Currin, Bajram Manin, Bajram Daklanin iu kundërvunë ekspeditave të Shefqet Turgut pashës në Qafë të Morinës, deri në thellësi të zonave të Malësisë së Gjakovës. Ishte ndër figurat e njohura në Kuvendin e Junikut. U shqua edhe në organizimin e rezistencës së shqiptarëve kundër forcave serbo-malazeze 1912-1915. U vra në një përleshje të ekspeditës ushtarake austro-hungareze në Bjeshkën e Gjarprit në Malësinë e Gjakovës. (Jusuf Bajraktari)

HALIMI Avni (1965-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Shkup, kurse në Universitetin e Prishtinës kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Si student punoi në gazetën studentore “Bota e re”, si gazetar dhe redaktor në rubrikën e kulturës. Nga viti 1994 punoi si redaktor dhe kryeredaktor në javoren “Hëna e re”. Deri më tani ka botuar librat me poezi: “Rojtar i natës” (1989), “Vjeshtë në teatër” (1994), “Balsami i pritjes” (2004),

“Albumi i kujtesës” (2006). Ka botuar romanin “Duke pritur pranverën” (2002), përmbledhjen me tregime “Kohë ujqërish” (2008). Dramat “Kjo është lufta ime” dhe “Labirintet e kujtesës” janë botuar në gjuhën bullgare, maqedonase dhe angleze. Në vitin 2008 u botua në maqedonisht libri me tregime “Maratonisti”. Ndërkaq, në vitin 2002 në Teatrin Shqiptar në Shkup u shfaq drama “Kjo është lufta ime”. Në vitin 2007 drama “Labirintet e kujtesës”, e inskenuar po në Teatrin Shqiptar në Shkup, u shpërblye në Festivalin ndërkombëtar “Vojdan Çernodrinski” në Prilep. (Salajdin Salihu)

HALIMI Bedri (1963-). Gazetar, poet. Lindi në Kuk të Dragashit. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe Prizren, ndërsa studimet për blegtori i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. U burgos në vitin 1981 dhe u dënua me tri vjet burg. Pas vitit 1990 punoi redaktor në gazetën “Bashkimi social” të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, më pas kryeredaktor në agjencinë e lajmeve “Kosovapress” dhe redaktor përgjegjës në gazetën “Infopress”. Botoi punime publicistike në disa gazeta dhe revista në gjuhën shqipe. Ishte pjesëmarrës në luftën e UÇK-së që në fillimet e saj. Nga fusha e letërsisë botoi libra me poezi për fëmijë dhe të rritur: “Ditar Dardanie” (1992), “Plagë shpirti” (1995), “Cubat fshehin hënën” (1999), “Kafshët e botës sime” (2001); pastaj: “Qëndresa kombëtare në Opojë dhe dëshmorët e saj” (2002), “Haxhi Ymer Prizreni” (2006), “Dëshmorët e Opojës” etj. (Artan Krasniqi)

HALIMI Blerim (1978-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe shkollën e mesmen ekonomike i kreu në Prishtinë, ku më pas mbaroi edhe studimet në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, dega e gazetarisë. Në vitin 2000 një kohë punoi te “TV AA”, pastaj në të përditshmen “Rilindja”. Po në atë vit kaloi me punë në gazetën “Kosova sot”, ku qëndroi deri në fund të vitit 2013, si gazetar dhe redaktor i sportit. Njëkohësisht ishte edhe kryeredaktor në portalin “Futbolli.com” dhe gazetar sporti në RTK, në njësinë e uebit (rtklive.com). (Besim Kajtazi)

HALIMI Halit (1943-). Gjuhëtar dhe profesor i frëngjishtes. Lindi në Miratoc të Preshevës. Studimet universitare i ndoqi në Sorbonë të

Francës (1971-1973). Studimet e doktoratës i kreu gjithashtu në Sorbonë, ku më 1990 mbrojti tezën “Fonetikë dhe fonologji e shqipes në vështrim të një studimi kontrastiv me frëngjishten standarde” (Phonétique et phonologie de l'albanais en vue d'une étude contrastive avec le français standard). Në Paris, në Institutin Kombëtar për Studime Orientale u diplomua edhe për letërsi e civilizim rumun. Më herët, në Universitetin e Zarës kreu pedagogjinë e përgjithshme (1970). Në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës filloi punë që nga viti 1974, si ligjërues dhe profesor për lëndët fonetikë frënge dhe leksikologji. Studimet e tij i takojnë fushës së fonetikës dhe të fonologjisë. Studimi i fundit sjell një analizë eksperimentale të theksit: “Parametrat akustikë të theksit të shqipes. Studim eksperimental” (2008). (Ardita Berisha)

HALIMI Hida (1948-2012). Shkrimtare, publiciste. Lindi në Radac të Pejës. Shkollën fillore e kreu në Jabllanicë të Vogël, të mesmen në Pejë, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin



HIDA HALIMI

e Prishtinës. Në vitet 1979-1980 ndoqi studimet pasuniversitare të shkencave juridike në “Aix-en-Provence”, Francë, ku kreu edhe kursin për letërsi frënge. E drejta ndërkombëtare ishte fushë në të cilën u specializua dhe për të cilën punoi deri në fund të jetës. Në periodikun shqiptar herë pas herë publikoi pjesë nga krijimtaria e saj artistike, kryesisht poezi, por edhe tregime të shkurtra. Vokacioni i saj kryesor mbeti krijimtaria letrare. Në vitin 1993 botoi librin me poezi “Vendlindjen ma zgjodhe ti”. Dy vjet më vonë romanin “Ai që nuk ishte Fidia”, për të vazhduar me romanin “Njeriu im” (1997), dramat “Bijtë e njeriut” (2001) dhe “Tri medaljonet e Franc Ferdinandit” (2001) dhe përmbledhjen me novela dhe tregime “Ato letra i shkrova vetë” (2007). Më 2007 romani “Njeriu im” u botua në frëngjisht nga Shtëpia Botuese “Publibook” në Paris, me titullin “Ju do të ecni pas hijes tua” (Tu marcheras derrière ton ombre). “Shpina” është romani i saj i fundit, i botuar një vit pas vdekjes (2013). “Ai që nuk ishte Fidia” është romani që ka

marrë më shumë vlerësime nga kritika letrare shqipe. H. Halimi ishte laurate e disa çmimeve letrare brenda dhe jashtë vendit. (Agron Gashi)

HALIMI Iljaz (1954-). Politikan. Lindi në fshatin Shushikë, Republika e Kosovës. Diplomoi për sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë punoi



ILJAZ HALIMI

si mësimdhënës në një shkollë të mesme në Tetovë. Ishte kryetari i dytë dhe i fundit i Partisë Demokratike Popullore (PDP), pastaj kaloi në Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH). Në zgjedhjet e vitit 1998 u zgjosh deputet i PDSH-së dhe nënkryetar i Parlamentit të Maqedonisë. Mbajti edhe postin e nënkryetarit të Partisë Demokratike Shqiptare. Ishte deputet edhe në legjislaturën 2002-2006 dhe anëtar i Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë. Një kohë mbajti edhe postin e zëvendësministrit të Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë. Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 ishte kandidati i vetëm shqiptar, i nominuar nga Partia Demokratike Shqiptare. (Arsim Sinani)

HALIMI Kadri (1921-2001). Etnolog. Lindi në fshatin Cërrnicë të Gjilanit. Kreu Medresenë e Madhe në Shkup në vitin 1941 dhe u diplomua për etnologji në Fakultetin Filozofik të



KADRI HALIMI

Universitetit të Beogradit më 1950. Ishte etnologu i parë shqiptar nga Kosova. Punoi si asistent në katedrën e etnologjisë po në Beograd, ku u arrestua dhe vuajti burg në Goli Otok. Punoi në Muzeun e Kosovës si kustos dhe në disa vende të tjera në Prishtinë. Në periudhën 1955-1961 ishte zëvendës drejtor dhe përgjegjës i Seksionit Etnografik të Muzeut të Kosovës. Në mars të vitit 1961 sërish burgoset dhe dënohet me 7 vjet e gjysmë burgim. Është autor i disa librave dhe i monografive nga fusha e studimeve etnografike dhe të letërsisë popullore: “Kangë Popullore shqiptare të Kosovë-Metohisë” (bashkautor, 1952), “Studime etnologjike” (1994), “Shkëndije e lirisë” (monografi publicistiko-shkencore e

dokumentare, 1995) dhe “Trajtime e studime etnologjike” (2000). (Nita Luci)

HALIMI Mehdi (1971-). Gjuhëtar, përkthyes dhe profesor. Lindi në Podujevë. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin INALCO, Francë. Doktoroi në vitin 2001. Punoi si profesor i gjuhës frënge në gjimnazin e Podujevës dhe më pas profesor asistent në Universitetin e Prishtinës. Botoi punime në revista shkencore në Prishtinë dhe jashtë vendit. Ka përkthyer nga frëngjishtja vepra të Andre-Ivës, Portnofit dhe Cvetan Todorovit. Jeton në Paris. (Ardita Berisha)

HALIMI Mehmet (1937-). Gjuhëtar, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Cërrnicë të Gjilanit. Shkollimin e mesëm e mori në



MEHMET HALIMI

Gjilan dhe në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu po në Prishtinë (1964). Studimet pasuniversitare i nisi në Beograd dhe i përfundoi në Prishtinë, ku gjithashtu mbrojti edhe tezën e disertacionit të doktoratës për të folmen e Karadakut (2000). Nga viti 1968, derisa u pensionua, punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në fillim si asistent në sektorin e dialektologjisë, pastaj hulumtues i pavarur, bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor, deri në këshilltar shkencor. U mor me studime dialektesh të gjuhës shqipe, pastaj me hulumtimin dhe gjurmimin e onomastikës, në lëmin e kulturës së gjuhës shqipe, mbi dy rrafshet, në rrafshin e kulturës së drejtshkrimimit dhe në rrafshin e drejtshqiptimit të shqipes normative. Botoi veprat “Kështu fliste babai im” (1997), “Monografi dialektologjike për të folmen e Moravës së Epërme” (1978), të Moravës së Poshtme (1985), të Kabashit (1985), të fshatrave Mjak e Tanishec, të fshatrave Mramor dhe Marec (1985), “Vështrime gjuhësore” (1993), monografinë “E folmja e Karadakut” (2008) etj. Është anëtar korrespondent i ASHAK-ut nga viti 2012. (Bahri Koskoviku)

HALIMI Nexhat (1949-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në fshatin Dumnicë të Podujevës. Kreu




NEXHAT HALIMI

shkollën fillore e gjimnazin në Prishtinë, ku ndoqi dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik. Një kohë të gjatë punoi si gazetar, reporter dhe redaktor në të përditshmen “Rilindja”. Ishte dhe redaktor për faqet e kulturës dhe të letërsisë në revistën “Zëri i rinisë”, “Illyria post” dhe “Pavarësia”. Shkruan për të rritur dhe për fëmijë. Është autor i një varg librash me poezi, proza e drama: “Parakalimi i etjeve”, “Deri në kryq”, “Afërsia e largësisë”, “Hark”, “Dita e daljes”, “Truphija”, “Gjeli i dylltë”, “Molla e fshehur”, “Fajtori mitik”, “Prania e së dielës”, “Ombrella”, “Vapë”, “Unë me Unë”, “Njeriu me zgjedhë”, “Dega e varur mbi varr”, “Requiem për fluturën”, “Lulja që qan”, “Udhëtimi në vete”, “Iluzioni i fluturimit”, “Rrënjë e kaltër”, “Fyelli i gjallë”, “Narcis i gjakosur”, “Vigma e fajkoit”, “E çara në zotin”, “Shelgu somnambul”, “Kotelja e artë”, “Dritarja me pamje në lumë”, “Vetëtimia e shpatës”, “Trëndafili me zemër”, “Zogu fle në çinar”, “Vjedhësit e hënës”, “Kaq vetëm Fedor”, “Angështia”, “Katana e purpurt”, “Zoti nuk ka vdekur” etj. Është përkthyer dhe përfaqësuar me poezi e prozë në shumë antologji në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. (Zejnullah Rrahmani)

HALIMI Njazi (1920-2011). Mjek, internist pulmolog. Lindi në Gjilan. Shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, Medresenë e Madhe e kreu në Shkup, ndërsa maturën në Prishtinë. Në vitin 1953 kreu Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, si njëri ndër të parët mjekë shqiptarë nga Kosova. Punën e mjekut e nisi në Prizren. U burgos dhe u dënua me burg si anëtar i NDSH-së. Pas vuajtjes së burgut u kthye në vendlindje, ku punoi deri në vitin 1970. Kreu specializimin për sëmundjet e mushkërive më 1966 në Beograd. Po atë vit u bë drejtor i përgjithshëm i Qendrës Mjekësore në Gjilan. Më 1970 u shpërngul familjarisht për në Turqi, por një vit më vonë u kthye në Prizren, ku punoi si shef i dispanserit të tuberkulozit. Më pas punoi në Rahovec dhe në vitet e fundit para pensionimit (1987) punoi në Gjilan. Vdiq dhe u varros në Bursë të Turqisë. (Drita Maksuti-Berisha)

HALIMI Raif (1926-1999). Veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare, i burgosur politik. Lindi në Cërnicë të Gjilanit. Ishte i biri i Ramiz Cërnicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore shkoi në Gjermani për të vazhduar shkollimin. Më pas u kthye në Kosovë dhe u regjistrua në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë. U përfshi në Luftën Antifashiste, në radhët e Brigadës së Parë Sulmuese të Kosovës, ku u zgjodh komisar i batalionit IV. Kur njësitë i tij mori urdhër të zhvillojë luftime kundër forcave të Shaban Polluzhës në Drenicë, së bashku me komandantin e Batalionit IV, Jusuf Kiki, R. Halimi iu bashkua forcave të Shaban Polluzhës (natën e 30-31 janarit 1945), pasi më parë kishin likuiduar në Prekaz disa nga kuadrot komanduese serbe të kësaj brigade. Pas këtij aksioni u zu dhe më 25 prill 1945 gjyqi ushtarak e dënoi me pushkatim. Për shkak të moshës së re, dënimi iu shndërrua në 20 vjet burg. Në burg u mor me përkthime, hartoi fjalorë dhe shkroi vepra origjinale, të cilat iu konfiskuan. Më vonë përktheu disa tekste të kontabilitetit për studentët e Fakultetit Ekonomik, që nuk u botuan me emrin e tij. Me themelimin e Partisë Nacional-Demokratike Shqiptare në vitin 1990 u zgjodh anëtar i kryesisë. Vdiq dhe u varros në Fshatin e Vjetër të Ferizajt. (Fehmi Rexhepi).

HALIMI Riza (1947-). Politikan. Lindi në Preshevë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për fizikë i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi mësimdhënës në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë, më pas u angazhua në politikë, duke themeluar (gusht 1990), Partinë për Veprim Demokratik (PVD) në Preshevë, kur u zgjodh edhe kryetar i saj. PVD-ja është partia e parë politike e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, në kohën e pluralizmit politik. Më 1992 u zgjodh kryetar i KK të Preshevës, funksion që e ushtroi për disa mandate. Gjithashtu u zgjodh tri herë deputet në Kuvendin e Republikës së Serbisë, së fundi si deputet i pavarur. (Qerim Qerimi).



RIZA HALIMI

HALIMI Shkëlzen (1961-). Shkrimtar, publicist. Lindi në Preshevë. Mbaroi shkollën fillore dhe të mesme në Shkup. Kreu dhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik. Punoi në gazetën “Flaka”, “Bota sot”, “Fakti”, kurse aktualisht punon si redaktor në gazetën “Koha”. Është autor i librave me poezi: “Ujem dashurie”, “Qeshje pa zë”, “Beti blu në Bit Pazar”, “Rruga kobër”, “Lule në shkretëtirë” dhe me tregime: “Agshol i grisur”, “Vdekja e Vincentit” dhe “Oda e rrëfimit”, si dhe i romanit “Kthimi”. Është autor i disa dramave të inskenuara në skenat e Tetovës, të Shkupit dhe të Kumanovës. Është marrë edhe me përkthime. Poezia dhe dramat e tij janë vlerësuar nga kritikë e studiues. (Salajdin Salihu)

HALIMI Zymer (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Svirçë të Banjës së Sijarinës, komuna e Medvegjës në Kosovën Lindore. Kreu Shkollën e Mesme Ushtarake në Beograd, ndërsa studimet në Akademinë Ushtarake në Beograd dhe Sarajevë. Kontaktet e para me UÇK-në i vendosi në fillim të vitit 1998. Më 24 qershor 1998 u inkuadrua drejtpërdrejt në UÇK dhe më pas u emërua në pozitën e zëvendëskomandantit të Brigadës 141 “Mehë Uka” të Zonës Operative të Shalës. Gjatë periudhës së luftës u plagos dy herë. Ishte pjesëmarrës në betejat që u zhvilluan në Mazhiq, Preten, Kaqandoll, Gumnishtë, Kurillovë etj. Pas lufte kreu detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Më pas ishte zëvendëskomandant i Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe drejtor i drejtorisë së operacioneve në Ministrinë e FSK-së. (Miftar Kurti)

HALITAJ Agron (1972-). Gazetar. Lindi në Zabërgjë të Klinës. Shkollimin fillor e kreu në Ujëmir, gjimnazin në Klinë, studimet për gazetari në Prishtinë, ndërsa i vazhdoi në Universitetin Viadrina të Frankfurtit mbi Odër, me seli në Sofje. Nga viti 2003 e deri më 2013 ishte gazetar në të përditshmen “Koha ditore”, ku shkroi kryesisht për tema politike. Më 2013 emërohet redaktor i politikës në gazetën “Tribuna”, kurse në vitin 2015 drejtor i informacionit në Tribuna Media Group. Gjatë punës aktive si gazetar mori disa çmime, përfshirë çmimin “Rexhai Surroi” nga gazeta “Koha ditore” dhe çmimin e Asociacionit

të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës për shkrimin më të mirë në fushën e politikës. (Artan Krasniqi)

HALITI Arben (1976-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Ozdrim të komunës së Klinës. U bë pjesëtar i UÇK-së në janar të vitit 1998. Mori pjesë në betejat që u zhvilluan në Drenicë, si në Ozdrim, Vojnikë e në Açarevë. Ishte komandant i skuadrës diversante, në pikën ushtarake “Zalla” të Ozdritit. Me këtë njësit kreu aksione të shumta në Jashanicë, Çitak, Padalishtë, Belicë, Kërnice dhe Llaushë. Më 20 maj 1998, në betejën e zhvilluar në zonën ndërmjet fshatrave Kryshec e Budisalc, u plagos. Forcat serbe e kapin të plagosur dhe e torturojnë deri në vdekje. Në nderim të veprës së tij, Zona Operative e Drenicës e emëroi Brigadën 112 me emrin e tij. (Haxhi Ademi)

HALITI Behxhet (1958-). Gazetar. Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi gazetar dhe redaktor në gazetën studentore “Bota e re” (1979-1981), ku ishte edhe kryeredaktor, më pas gazetar në revistën “Zëri i rinisë” (1981-1982). Nga viti 1984 e deri më 1999 punoi në gazetën e përditshme “Rilindja” (“Bujku”), si gazetar e ndihmës i redaktorit, ndërsa pas luftës (nga viti 1999 e deri më 2006) zëvendëskryeredaktor dhe kryeredaktor në javoren politike “Zëri” (2008-2012). Nga viti 2012 punon në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në periodikun letrar botoi kohë pas kohe poezi dhe tregime. (Veli Bytyçi)

HALITI Flaka (1982-). Grafiste, artiste e mix medias. Lindi në Prishtinë. Kreu Akademinë e Arteve, drejtimin e grafikës më 2006 në Universitetin e Prishtinës. Më pas kreu Akademinë e Arteve të Bukura në Städtelschuleme Meisterschule në Frankfurt (2013). Nga viti 2013 është në programin doktorat në Akademinë e Arteve në Vjenë. Grafika si medium dydimensional i shërbeu si përvojë fillestare për eksplorimin e hapësirave me përmasa tridimensionale në skulpturë, fotografi, me ndërhyrje të formësimit të trajtave dhe formave artistike. Mbajti disa ekspozita personale: në pavijonin

e Kosovës, në Bienalen e Venecias (2015), në Stokholm në “Testa konsthall” dhe në Munih në “Prince of Wales”, pastaj gjatë vitit 2014 në Vjenë, Mumok, në “Muzeun e Artit Modern”, në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë, në “Studionihil Baxter” dhe “Abc-Berlin” në Berlin, si dhe më herët në “Panairin e Artit Bashkëkohor”, në “Stacion”, në “Platform Sara” në Frankfurt (2010), pastaj në Shkup, Maribor etj. Mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta, si në Nju-Jork dhe Mançester (2015), në Frankfurt dhe Beograd (2014), në Karlsruhe dhe Beograd (Salloni 54 i Tetorit) dhe më herët në Sarajevë, Vjenë, Stokholm, Zagreb, Berlin, Novi-Sad, Bruksel etj. Jeton dhe punon në Munih të Gjermanisë. (Fatmir Krypa)

HALITI Mentor (1975-). Dramaturg, poet, gazetar. Lindi në Tërrnoc të Bujanocit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për dramaturgjii i ndoqi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Për disa vjet punoi si gazetar i kulturës në gazetën “Koha ditore” dhe në disa gazeta të tjera të Kosovës. Ka qenë anëtar i redaksisë së revistës për teatër “Loja”. Është autor i dramave “Uluni, ju lutem” (2002), “Një udhëtim në Unmikistan” (bashkautor), “Hauptbahnhof” (dramatizim, 2003), “Të sëmurët nga pashtetësia” (2003), “Loja e dramës” (2004), “Të paftuarit” (dramatizim, 2007), “Caffe” (2008) dhe “Fabrika e kukullave” (2010). Me dramën “Caffe” fitoi çmimin e tretë në konkursin për dramë origjinale “Katarina Josipi” (2008). Në bashkëpunim me Faruk Begollin shkroi komedinë “Zoti kryetar, një gotë eks për seks”, e cila është vënë në skenë në Teatrin “Dodona” në Prishtinë. Botoi gjithashtu librat me poezi “Të thella janë rrënjët”, “Shkallët e shtëpisë” dhe “Provokim”. (Naime Beqiraj)

HALITI Njazi (1955-2007). Arkitekt konservator-restaurues. Lindi në Banullë të Lipjanit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje dhe në Lipjan, ndërsa studimet i përfundoi në Universitetin e Prishtinës. Punoi në Entin Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë, në sektorin e arkitekturës për konservim-restaurim, ku fitoi gradat dhe titujt profesionalë nga kjo fushë. Një kohë ishte edhe drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Realizoi një numër projektesh për restaurimin

e objekteve të palëvizshme, ndërtime arkitekturale të karakterit fetar e laik, monumente publike e banesore në territorin e Kosovës. Evidentoi dhe përcaktoi kriteret vlerësuese për një numër monumentesh dhe krijoi dosje për trashëgiminë e kulturës materiale. Udhëhoqi disa projekte restauruese siç janë: Xhamia Vjetër në Deçan, kulla e Ali Bajraktarit në Vranoc të Pejës etj. Është bashkautor i disa publikimeve të botimeve profesionale, ndër të cilat edhe i monografisë: “Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII-XIX” (2006). (Fejz Drançolli)

HALITI Sabedin (1945-). Gazetar. Lindi në fshatin Rahovicë të Preshevës, ku kreu shkollimin fillor dhe gjimnazin. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga 1969 e deri më 1979 punoi në gazetën e përditshme “Rilindja”, si gazetar dhe redaktor. Gjatë punës në të përditshmen “Rilindja” kryesisht shkroi për film, kritika dhe recensione. Nga viti 1979 e deri më 1981 ushtroi detyrën e kryeredaktorit të revistës “Fjala”. Pas demonstratave studentore të vitit 1981 u arrestua dhe u dënua me tri vjet burg për “propagandë armiqësore”. Pas vitin 1990 rikthehet në detyrën e redaktorit në revistën “Fjala”. Nga viti 1993 punon në Qendrën për Informim të Kosovës. (Shefket Rexhepi)

HALITI Shefik (1942-). Pedagog, mësimdhënësi universiteti. Lindi në Muhoc të Bujanocit, ku kreu shkollën fillore dhe semimaturën. Arsimin e vazhdoi në Normalen e Gjilanit, studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi (1983). Fillimisht ishte mësues në shkollën fillore në vendlindje, pastaj mësimdhënësi në Normalen e Gjilanit dhe më pas në Akademinë Pedagogjike, përkatësisht Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjilanit, ndërsa nga viti akademik 2003/12 punoi si mësimdhënësi i lëndëve pedagogjike në qendrën rajonale të Fakultetit të Edukimit në Gjilan. Ndërkohë u zgjodh edhe në pozita drejtuese dhe përfaqësuese të arsimit të lartë. Botoi tekste të publicistikës pedagogjike, si dhe disa vepra me përmbajtje arsimore dhe pedagogjike: “Artikuj të përzgjedhur pedagogjike” (2003), “Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në komunën e Gjilanit 1945-1975” (2004), “Në kërkim të pedagogjisë reformuese” (2007) etj. (Januz Dervodeli)

HALITI Xhavit (1956-). Politikan, njëri nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Fshatin e Ri (Novosellë) të Pejës. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi



XHAVIT HALITI

shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Që kur ishte student u përfshi në aktivitete ilegale. Për këtë shkak ishte i përndjekur dhe i burgosur. Ndaj tij policia serbe organizoi disa atentate. Duke qenë i përndjekur, u detyrua të emigrojë në Zvicër, ku vazhdoi aktivitetin politik në radhët e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Gjatë viteve 1987-1999 ishte anëtar i Kryesisë së LPK-së. Në vitin 1993 u caktua në “Sektorin e rëndësisë së veçantë”, organ i cili kishte kompetenca të bashkërendojë aktivitetin e grupeve guerile që vepronin në Kosovë. Pas koordinimit të veprimtarisë së grupeve, ky sektor themeloi UÇK-në dhe caktoi Shtabin Qendror të UÇK-së (më pas Shtabin e Përgjithshëm). Gjatë luftës në Kosovë Xh. Haliti mbante lidhjet me udhëheqësit e grupeve guerile të UÇK-së, me zyrtarët e shtetit shqiptar dhe diplomatë të huaj. Mbante kontakte me të gjithë eprorët e UÇK-së. Gjatë kësaj kohe mbështeti dhe koordinoi furnizimin e rregullt të njësiteve të para të UÇK-së, e pas daljes së saj publike laujti rolin e diplomatit dhe mbrojti luftën e UÇK-së në bisedat e shumta me diplomatët e huaj, si dhe mbajti raportet me zyrtarët e shtetit shqiptar. Në Konferencën e Rambujesë ishte anëtar i delegacionit të Kosovës. Ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Pas lufte u angazhua në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe që nga viti 1999 është anëtar i kryesisë së saj. Që nga viti 2001 është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit. (Skënder Berisha)

HALITI-ETI Jetullah (1945-). Piktur. Lindi në Haxhaj të Gjilanit. Shkollimin e bazë e mori në Gjilan, ndërsa Fakultetin e Arteve e kreu në Prishtinë. Një kohë punoi si mësimdhënës i artit në gjimnazin e Gjilanit, më vonë mësimdhënës i metodikës së artit në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe në Gjilan. Është anëtar i Akademisë Europiane në Gambleaus me seli në Belgjikë. Opusi piktural i tij është i

gjerë, por cikli më i veçantë mbetet “Pëllumbat e paqes”, që cilësohet më i arriri në krijimtarinë e tij artistike. Për punën krijuese mori disa çmime, si “Medaljen e artë” në Sallonin 27 Ndërkombëtar në Belgjikë (1997), pastaj “Medaljen e artë” në Sallonin 28 Ndërkombëtar A. E. A. po në Belgjikë (1998), “Medaljen e argjendtë” të A. E. A. në Francë (1999), çmimin e parë për pikturë në “Flaka e janarit” në Gjilan (2001) dhe “Medaljen Internacionale” në Belgjikë (2002). Jeton dhe krijon në Gjilan. (Bislim Aliu)

HALITJAHA Sadik (1955-). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Mushtisht të Suharekës. Për veprimtari politike u dënua tri herë. Në periudhën 1986-1988 ishte njëri nga drejtuesit e lëvizjes ilegale në hapësirat shqiptare në ish-Jugosllavi. Pas daljes nga burgu në qershor të vitit 1988 u arratis në Shqipëri dhe që andej emigroi në Zvicër, ku e vazhdoi veprimtarinë politike. Ishte komandant i batalionit të UÇK-së në Budakovë, ku u plagos në betejën e 23 gushtit 1998. Pas shërimit, kaloi në komandën e Nënzonës Operative të Pashtrikut, ku u emërua ndihmëskomandant për çështje moralopolitike. Me krijimin e Zonës Operative të Pashtrikut (1998) nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, u emërua zëvendëskomandant i Zonës. Ishte pjesëmarrës i shumë luftimeve dhe betejave me njësitin e tij. Pas luftës kreu detyra me rëndësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. (Ali Uka)

HALKOKONDILI Laonik (rreth 1425-rreth 1490). Historian dhe shkrimtar bizantin. Lindi në Athinë. Ishte bashkëkohës i rënies së Konstandinopojës (1453) dhe Trapezuntit (1461). Në vitet '80 të shek. XV shkroi veprën “Vështrime nga historia” në dhjetë libra, një histori koncize që nis me Asirinë e Lashtë dhe arrin deri te themelimi i Perandorisë Osmane (1298). Ndryshe nga kronistët dhe historianët e tjerë bizantinë, Halkokondili në historinë e tij nuk pati temë interesimi Perandorinë Bizantine, që në kohën e tij ishte në shkatërrim e sipër, por shtetin e ri osman, i cili ngrihej me shpejtësi të madhe mbi gërmadhat e Bizantit. Brenda këtij kuadri kronologjik, në librin VII ofron njoftime interesante për Betejën e Dytë të Kosovës (1448), përkatësisht për marrëdhëniet e Huniadit me Skënderbeut në këtë periudhë. Në kontekst të betejës përmenden gjithashtu

edhe qyteti i Novobërdës (Novopir), i Prishtinës, së bashku me Fushë-Kosovën dhe rajonin e gjerë të Mezisë (Dardanisë). Përveç kësaj, vepra e Halkokondilit jep njoftime edhe për etnogjenezën dhe shtrirjen e arbërve dhe të Arbërisë gjatë mesjetës, mbi pushtimet e para osmane, zotërimet e Gjon Kastriotit dhe Gjergj Arianitit, për kryengritjen në zotërimet e Gjergj Arianitit, për Luftën e Sfetigradit (1448), për disfatën e Murtaut II në Krujë (1450), për arvanitët e Peloponezit dhe kryengritjet e tyre etj. Për dallim nga historianët e tjerë të epokës, përshkrimin e luftërave të popujve ballkanikë kundër osmanëve e bën pa paragjykim. Vepra e tij konsiderohet si një burim i rëndësishëm për historinë e shekujve të fundit të periudhës bizantine. (Gazmend Rizaj)

HALVETIZMI. Është rrugë mistike islame, e themeluar nga nxënësi i Ibrahim Zahid Gejlanit, Omer el-Halvetiut (vdiq më 1349). Halveti (vetmia) ishte njëra nga trajtat më të preferuara në pastrimin dhe edukimin e shpirtit dhe pranohej si një nga parimet themelore të jetës askete. Edhe pse themelues i halvetizmit është Omer el-Halvetiu, vendosja e parimeve themelore dhe përhapja e kësaj rruge mistike u bë nëpërmjet kryeplakut të dytë, Sejid Jahja Shirvaniut (vdiq më 1464) dhe ndjekësve të tij. Tarikati Halveti është një ndër tarikatat më të përhapura në Kosovë. Në mesin e shumë degëve dhe nëndegëve të këtij tarikati, në Kosovë kanë qenë të pranishme: ramazanie, xherrahie, hajatie dhe sinanie. Teqeja halvetiane në qendër të Prizrenit është themeluar nga ana e pir Osman Babait, i cili lindi në fshatin Vezhë të Lumës. Pas mësimeve të para në vendlindje, sheh Osman Babai shkoi në Serez dhe aty e mori edukimin pranë shehut të njohur halveti, pir Husejin Serezitit (vdiq më 1699) dhe u kthye në Prizren në fillim të shekullit XVIII, ku e ka themeluar teqenë. Teqeja e themeluar nga sheh Osman Babait, së bashku me teqenë Halveti-Hajati, të themeluar nga pir Mehmed Hajatiu në Ohër, ishin qendrat kryesore të halvetizmit në trojet shqiptare. Teqe të halvetinjve kishte pothuajse në të gjitha qytetet shqiptare. (Metin Izeti)

HALLAÇI Selami (1919-1944). Aktivist i Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Lindi në Preshevë. Shkollën fillore e kreu në Preshevë. Më vitin 1930 u regjistrua në Medresenë e Madhe të Shkupit. Përfundoi nga medreseja,

për shkak se iu zbuluan disa broshura në gjuhën shqipe. Pas përfundimit nga medreseja, regjistrohet në gjimnazin e Prilepit. Punoi si mësues në Gjiçan. Në vitin 1942 udhëhoqte celulën e mësuesve komunistë. Si sekretar i celulës mbante lidhje edhe me komunistët e Preshevës, Ferizajit, Lipjanit dhe të Prishtinës. Emërohet sekretar i Inspektoriatit të Arsimit për Prefekturën e Prishtinës (1943/1944). Gjatë kësaj kohe vepronte me emrin ilegal "Novak". Për shkak të aktivitetit të tij, Gestapoja e burgos dhe dërgohet në kampin e Prishtinës. Në gusht të vitit 1944 u dërgua në Prizren, ku u ekzekutua me varje. (Ilir Zylfiu)

HAMAMET (shek. XV-XVI-XVII). Janë banja të vjetra publike, të ndërtuara në afërsi ose në kuadër të disa xhamive në Kosovë. Këto banja në popull njihen si hamame. Ndërtime të këtilla monumentale me karakter shoqëror-publik ka pasur në disa qytete të Kosovës. Edhe pse në disa raste u janë përshtatur nevojave bashkëkohore, ende ruajnë mjaft elemente origjinale dhe fillestare. Banjat publike patën përhapje të gjerë gjatë sundimit të Perandorisë Osmane në territoret shqiptare, por ka pasur edhe gjatë sundimit romak-bizantin. Nga hamamet e mbetura janë: Hamami i Ali Beut në Vushtrri, Hamami i Madh në Prishtinë, Hamami i Haxhi Isa Beut në Pejë nga shek. XV, Hamami i Gazi Mehmet pashës në Prizren (shek. XVI), ose Hamami i Pashës në Prishtinë, si dhe Hamami i Badivukëve në Mitrovicë (shek. XVIII). Hamami i Ali Beut dhe i Badivukëve janë tek, ndërsa ndërtimet tjera janë të tipit çift. Te hamamet shfrytëzoheshin gjatë ditës nga të dy seksjet, por në kohë të ndryshme të ditës, ndërsa çift hamamet shfrytëzohen nga të dy seksjet në mënyrë të vazhdueshme, gjatë tërë ditës. Në aspektin arkitekturor-funksional, hamami përbëhet nga ambientet e shatërvanit, të kapallëkut, të hamamit, të haznës, të qylhanës dhe të hipokaustit. Ndërtimet kanë bazë katërkëndëshe kënddrejtë dhe janë të mbuluar me kube, qemer dhe çati. Struktura e murimit është e përzier: gurë dhe tulla të lidhura me llaç gëlqereje. Hamamet kanë vlera të posaçme për artin e arkitekturës tradicionale dhe dallohen me pamjen e tyre në mjedisin ku janë ndërtuar. (Fejaz Drançolli)

HAMIDI Valdet (1946-). Piktur. Lindi në Pejë, ku kreu Shkollën e Mesme të Artit (1967),

ndërsa në Prishtinë mbaroi studimet në grupin e dramës të Shkollës së Lartë Pedagogjike (1969). Emigroi nga Kosova dhe kreu studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Londër dhe në Akademinë Mbretërore të Arteve në Bruksel, ku u diplomua më 1972. Në vitet 1975/76 bëri udhëtime studimore dhe ekspozoi në SHBA, Meksikë, Kanada, Amerikë Latine etj. Jetoi një kohë në Bruksel (deri më 1983), pastaj në Paris dhe më vonë në Honfleur (Francë), ku jeton dhe sot. U dëshmuar si krijues në pikturë, duke gjetur shprehjen në një spektër të gjerë motivesh. E gjejmë në monografinë “50 vjet të pikturës bashkëkohore vështruar nga Dominik Stal në veprat e 61 piktorëve 1985-2000”. Artin e tij e karakterizon gjuha bashkëkohore e një zhanri specifik, poetika si thelb i veçantisë e shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë, energjia krijuese dhe etnia si metaforë e së kaluarës dhe simbolikë e qytetërimit. Në vitet e fundit realizoi disa cikle: “Motive dardane”, “Muzika në skenë”, “Pëshpëritje të ndaluar”, “Njeriu në hap”, “Portrete” etj., që patën jehonë të kritika dhe publiku. Realizoi shumë ekspozita personale e kolektive në Francë e gjetiu. Veprat e tij gjenden në muze, galeri e koleksione private. (Blerim Luzha)

HAMITI Abdullah (1958-). Filolog, orientalist, gazetar dhe përkthyes. Lindi në Tërnoc të Bujanocit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, kurse medresenë në Prishtinë. Studimet i



ABDULLAH HAMITI

përfundoi në Prishtinë, ku gjithashtu mbaroi studimet pasuniversitare dhe doktoratën. Gjatë viteve 1982-1986 punoi si gazetar në “Rilindje”. Më pas kaloi në degën e orientalistikës në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Aktualisht është profesor i asociuar për gjuhën dhe letërsinë turke në degën e orientalistikës të Fakultetit të Filologjisë. Punoi gjithashtu ligjërues i gjuhës turke në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë (2002-2014). Veprimtaria shkencore-profesionale e tij shtrihet në fushën e orientalistikës, të albanistikës dhe të kulturave shqiptare e islame. Botoi artikuj, studime e monografi. Shquhet për interesimin për shkrimet shqipe me alfabet arab. Veçohet monografia e tij “Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip”

(2008). Kontribuoi në fushën e përkthimeve nga gjuhët turke e arabe në gjuhën shqipe, po edhe nga shqipja në turqisht. (Jahja Hundozi)

HAMITI Ali (1948-). Inxhinier i elektroenergjetikës, profesor universiteti. Lindi në Dumnice të Podujevës, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Podujevë, studimet në Fakultetin



ALI HAMITI

Teknik në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe të doktoratës i kreu në Universitetin e Zagrebit dhe në Universitetin e Prishtinës (UP). Në vitin 1973 u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të UP-së dhe një vit më vonë drejtor për investime dhe zhvillim në Radiotelevizionin e Prishtinës (1974-1987), më pas ndihmësdrejtor i përgjithshëm në Fabrikën “Ferronikeli” (1987-1992). U angazhua si mësimdhënës në Fakultetin Elektroteknik më 1993, ndërsa pas vitit 1999 u emërua në poste të larta menaxhuese në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës dhe në bordin udhëheqës të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë së Kosovës. Është autor i dispensave nga fusha e centraleve elektrike, të stabilimenteve elektroenergjetike, të tregut të energjisë elektrike etj. Është pjesëmarrës në një sërë konferencash shkencore dhe botoi punime profesionale në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është anëtar dhe bashkëpunëtor në shumë shoqata dhe institute profesionale, shkencore e hulumtuuese. (Isuf Krasniqi).

HAMITI Asllan (1960-). Gjuhëtar, profesor. Lindi në Goden të Gjilanit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Shkup, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Shkupit. Edhe studimet pasuniversitare dhe tezën e doktoratës e mbrojti në Shkup (1999). Punon në katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Shkupit, tani profesor ordinar për lëndët fonetikë dhe dialektologji. Ishte drejtues i katedrës dhe i degës së gjuhësisë në studimet e doktoraturës në Universitetin e Shkupit. Ka hartuar disa libra mësimorë dhe fletore pune të shqipes (për shqiptarë dhe joshqiptarë) për ciklin fillor dhe të mesëm (në bashkautorësi), si dhe tekstet universitare të fonetikës e fonologjisë dhe të gjuhës standarde shqipe, botuar e ribotuar në shqip (2005,

2011) dhe në maqedonisht (2008, 2011). Botoi artikuj profesionalë dhe monografitë “Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit” (2005), “E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit” (2014). (Berton Sulejmani)

HAMITI Ejup (1937-2008). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në fshatin Zasellë të Mitrovicës, ku kreu shkollën fillore. Gjimnazin e kreu në Prishtinë dhe Mitrovicë, studimet e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Beogradit (1959). Në vitin 1960 zgjidhet asistent në degën e matematikës të Fakultetit Filozofik të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Beogradit dhe tezën e disertacionit, në lëmin e algjebërës, e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1973). Në vitin 1970 zgjidhet docent në Fakultetin Teknik të UP-së, pastaj profesor inordinar dhe profesor ordinar (1979). Bëri vizita studimore në universitete të ndryshme të Europës dhe në SHBA. Në lëmin shkencor publikoi disa punime në revista ndërkombëtare e vendore dhe botoi disa tekste universitare dhe tekste për shkollat të mesme. Kreu detyra me rëndësi në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet e Kosovës (sekretar Krahinor për Arsim dhe Shkencë, 1986-1988). (Minir Efendija)



EJUP HAMITI

pas mori edhe titujt e tjerë universitarë, përfshirë edhe titullin profesor i asociuar (2010) për lëndët komunikimet pa tela, sistemet mikrovalore, antenat dhe telekomunikacionet. Në periudhën 2002-2011 ishte prodekan, ndërsa në vitin 2012 u zgjodh dekan i FIEK-ut. Merret me probleme të metodave analitike dhe numerike për trajtimin e strukturave planare. Si autor dhe bashkautor publikoi një sërë punimesh shkencore në revista të vendit dhe ndërkombëtare. (Isuf Krasniqi).

HAMITI Hamit (1954-). Aktivist i lëvizjes çlirimtare, pjesëmarrës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Repë, komuna e Podujevës. Në fund të viteve '70 u përfshi në lëvizjet ilegale dhe në vitin 1984 u arrestua dhe u dënua me 3 vjet burg. Me fillimin e rezistencës së armatosur u angazhua në logjistikën e Zonës Operative të Llapit të UÇK-së. U emërua shef i sektorit të logjistikës së kësaj zone. Bashkëpunoi me të gjitha shoqatat humanitare dhe të solidaritetit që funksiononin në atë kohë, pastaj me këshillat e emergjencës, me sindikatat, me bashkësitë fetare në Podujevë dhe në Prishtinë. Gjatë luftës logjistika e UÇK-së në Llap ndihmoi dhe u përkujdes edhe për popullsinë civile. Pas përfundimit të luftës H. Hamiti u angazhua në ndërtimin institucional të shtetit të Kosovës. (Ismet Cakiqi)

HAMITI Muhamet (1964-). Studiues i letërsisë, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Dumnicë të Podujevës. Kreu studimet në degën e gjuhës dhe të letërsisë angleze në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe magjistraturën i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoratën e mbrojti në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë (2006). Punon në Universitetin e Prishtinës nga viti 1989. Në vitet '90 ka bërë studime të pavarura në Birkbeck College të Universitetit të Londrës. Është autor i studimeve monografike mbi letërsinë angleze dhe përkthyes i kësaj letërsie në gjuhën shqipe dhe i letërsisë shqipe në anglisht. Në vitet '90 punoi si redaktor dhe përkthyes në anglisht i botimeve të shumta të Qendrës për Infomim të Kosovës. Ka qenë këshilltar për medie dhe zëdhënës i Presidentit Rugova, këshilltari i presidentit Sejdiu dhe ambasador i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar dhe ambasador jorezident në Zelandën e Re dhe në




ENVER HAMITI

Inxhinier i elektroteknikës, mësimdhënës universiteti. Lindi në Gjilan, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për inxhinieri elektrike i kreu në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1990). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Elektroteknik të UP-së, ndërsa studimet e doktoratës i mbaroi në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) po në UP (2006). Më 1991 u zgjodh asistent në Fakultetin Elektroteknik për lëndët bazat e elektroteknikës, sistemet telekomunikuese dhe mikrovalët. Më

Irlandë. Botoi studimin monografik “Aspekte të romanit të E.M. Forsterit” (1991), “Proza moderne: Xhozef Konradi dhe Xhejms Xhojsi” (2016) dhe “Besimi letrar” (2016). (Zejnullah Rrahmani)

HAMITI Sabri (1950-). Poet, prozator, studiues, dramaturg, akademik. Lindi në Dumnicë, ku kreu shkollën filllore. Gjimnazin e kreu në Podujevë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare në Zagreb e në Paris. U doktorua në Prishtinë. Punoi si redaktor i botimeve në “Rilindje” dhe profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës.



SABRI HAMITI

Vepri i lëvizjes demokratike, deputet i Kuvendit të Kosovës dhe firmëtar i pavarësisë së saj. Botoi veprat: “Njeriu vdes i ri” (1972), “Faqe e fund” (1973), “Variante” (1974), “Thikë harrimi” (1975), “Njëqind vjet vetmi” (1976), “Teksti i dramatizuar” (1978), “Trungu ilir” (1979), “Kritika letrare” (bashkautor me I. Rugovën) (1979), “A-ZH Nazmi Rrahmani” (1982), “Arti i leximit” (1983), “Leja e njoftimit” (1985), “Lind një fjalë” (1986), “Njeriu kryengritës” (1987), “Futa” (1988), “Vetëdija letrare” (1989), “Kaosmos” (1990), “Faik Konica: jam unë” (1991), “Tema shqiptare” (1993), “ABC” (1994), “Letërsia e vjetër shqipe” (1995), “Letra shqipe” (1996), “Poeti i nemun Bilal Xhaferri” (1996), “Misioni” (1997), “Letërsia moderne shqipe” (1998), “Lasgushi qindvjeçar” (1999), “Melankolia” (1999), “Bioletra” (2000), “Studime letrare” (2003), “Tematologjia” (2005), “Lulet e egra” (2006), “Memento për Rugovën” (2007), “Albanizma” (2009), “Utopia letrare” (2013), “At’ Zef Pllumi” (2013), “Ndre Mjedja” (2016). Në vitin 2002 botoi kompletin e veprave në 10 vëllime. Lirika e S. Hamitit nxit ndjesinë e refleksit të thellë, ndërsa studimet artikulojnë perceptim tërësor në kohë dhe hapësirë të letërsisë shqipe. Në poezi S. Hamiti është kërkimtar formash dhe shprehjesh të reja, kërkimtar edhe në këndin nga ku percepton botën përreth, që do të thotë edhe në ngasje frymëzimi. Librat e tij poetikë, prandaj, kanë kohezion të brendshëm si projekt, si frymë dhe përmbajtje. Janë unikë si format i librit tematik, që në vete ka

shkallët e hapjes dhe të përmbylljes. Teksti poetik thuret ashtu që herë-herë lejon ndajfutjen e zërave të tjerë. Për më shumë, në disa raste poezia shkon drejt prirjes së tekstit të dramatizuar poetik. Vargu në lirikën e tij është harmonik, nota e mendimit dhe e emocionit të balancuar. Dritarja që përmbillet brenda një libri - hovi poetik, hap dritare të re në fund të librit. Poezi e ngarkuar me dhembje, që artikulohet mjeshtërisht si art. Në fillimet e veta lirike ka notë lasgushiane dhe intonim ironik. Edhe në librat studimorë, vizioni synon projekte tërësore, sipas epokave, brezave dhe që përplotësohen nga libri në libër. Njësoj si në poezi, edhe në studimet e letërsisë, S. Hamiti ndjek një sistem të caktuar: librat përcjellin njëri-tjetrin në kontinuitet, përkatësisht i prijnë njëri-tjetrit. Në librat e tij studimorë vizioni synon projekte tërësore, që nga fillimet e letërsisë tonë, sipas epokave dhe brezave. Ai prek nyja historike, kthesa dhe fillime të rëndësishme, formacione stilistike në vazhdimësi, deri në ditët tona. Librat studimorë të S. Hamitit, të konceptuar kështu, qëndrojnë si histori e letërsisë shqipe. Ka marrë një sërë çmimesh letrare, dekoratash dhe mirënjohjesh publike. (Ali Aliu)

shkallët e hapjes dhe të përmbylljes. Teksti poetik thuret ashtu që herë-herë lejon ndajfutjen e zërave të tjerë. Për më shumë, në disa raste poezia shkon drejt prirjes së tekstit të dramatizuar poetik. Vargu në lirikën e tij është harmonik, nota e mendimit dhe e emocionit të balancuar. Dritarja që përmbillet brenda një libri - hovi poetik, hap dritare të re në fund të librit. Poezi e ngarkuar me dhembje, që artikulohet mjeshtërisht si art. Në fillimet e veta lirike ka notë lasgushiane dhe intonim ironik. Edhe në librat studimorë, vizioni synon projekte tërësore, sipas epokave, brezave dhe që përplotësohen nga libri në libër. Njësoj si në poezi, edhe në studimet e letërsisë, S. Hamiti ndjek një sistem të caktuar: librat përcjellin njëri-tjetrin në kontinuitet, përkatësisht i prijnë njëri-tjetrit. Në librat e tij studimorë vizioni synon projekte tërësore, që nga fillimet e letërsisë tonë, sipas epokave dhe brezave. Ai prek nyja historike, kthesa dhe fillime të rëndësishme, formacione stilistike në vazhdimësi, deri në ditët tona. Librat studimorë të S. Hamitit, të konceptuar kështu, qëndrojnë si histori e letërsisë shqipe. Ka marrë një sërë çmimesh letrare, dekoratash dhe mirënjohjesh publike. (Ali Aliu)

HAMITI Vjosa (1973-). Gjuhëtare, gjermaniste. Lindi në Prishtinë. Shkollimin parauniversitar e kreu në Frankfurt, në Prishtinë dhe Cyrih. Më 1996 mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi gjermane në Fakultetin të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Një vit akademik (1994-1995) të studimeve e mbaroi në Universitetin e Jenës (Gjermani). Më 2014 mbrojt tezën e disertacionit “Modaliteti epistemik - mundësitë e shprehjes së tij në gjermanisht dhe ekuivalentet në shqip” (Epistemische Modalität - die Äußerungsmöglichkeit im Deutschen und ihre Äquivalente im Albanischen) në Institutin e Gjermanistikës të Universitetit të Vjenës. Studimet postdoktorale në pragmatikë dhe pragmalinguistikë i bëri po në këtë institut. Që nga viti 1996 punon në departamentin e gjuhës dhe të letërsisë gjermane të Fakultetit të Filologjisë të UP-së. Në vitet 1999-2009 ishte bashkëpunëtorë nga Kosova për radion publike gjermane ARD. Ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe ka botuar një numër punimesh shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit nga fusha e gjuhësisë së përgjithshme. (Bardh Rugova)

HAMITI Zeqir (1958-). Dramaturg. Lindi në Dumnicë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërkaq të mesmen në Podujevë dhe në Prishtinë. Studimet për dramaturgji i ndoqi në Fakultetin e Arteve në Beograd. Punoi si skenarist në Televizionin e Prishtinës, në redaksinë e dramës dhe në Televizionin Shqiptar, programi satelitor, në Tiranë. Një kohë punoi edhe si pedagog në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë. Ishte drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe zyrtar në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit të Republikës së Kosovës. (Naime Beqiraj)

HAMODHAR Daut (1949-). Pikturor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. Shkollën e Lartë Pedagogjike, Akademinë e Arteve, degën e pikturës i kreu po në Prishtinë. Punoi si arsimtar në paralelet në gjuhën turke në shkolla fillore dhe të mesme në Prishtinë. Në vitet 1975-1997 ishte redaktor teknik në gazetën “Tan”, pastaj redaktor në Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Kosovës. Aktualisht është pedagog i jashtëm në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës dhe të Universitetit të Prizrenit, ku ligjëron artin figurativ dhe metodikën. Është i angazhuar nga Ministria e Arsimit rreth kurrikulave të artit figurativ në gjuhën turke. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe merr pjesë në aktivitetet e saj. Hapi disa ekspozita personale brenda dhe jashtë vendit dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive. Fryma ekspresive i përshkon motivet dhe imazhet e kompozimeve të tij nga cikli “Kaosi urban”. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Ilir Muharremi)

HAMZA Xhevdet (1920-1999). Funksonar politik në periudhën e autonomisë në Kosovë. Lindi në Gjakovë në një familje zejtarësh. Shkollën fillore e filloi në vendlindje dhe më pas e vazhdoi në Krumë të Hasit në Shqipëri. Pasi fitoi bursën e shtetit shqiptar, vijoi gjimnazin në Shkodër. Së bashku me grupin komunist të Shkodrës mori pjesë në demonstratën antifashiste të 28 nëntorit 1939, me ç’rast u arrestua dhe u përjashtua nga gjimnazi. Në Shqipëri qëndroi deri në prill të vitit 1941, kur u kthye në Gjakovë. Për shkak të një fjalimi të mbajtur më 28 nëntor të 1941 në Namazgjahun e Gjakovës, u detyrua të kalojë në ilegalitet. Në

këtë periudhë u angazhua në rininë antifashiste dhe Këshillin Nacionalçlirimtar të qytetit të Gjakovës. Pas vrasjes së Emin Durakut, e zëvendësoi atë në pozitën e sekretarit të Këshillit Nacionalçlirimtar (1942). Pas luftës ai u zgjodh sekretar i Këshillit të Rrethit të Gjakovës, e më pastaj punoi si gjykatës në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë (1945). Pas Plenumit të Brioneve u emërua sekretar i Punëve të Brendshme të Kosovës (1966), ndërkaq më 1974 u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Kosovës. Më 1982 u zgjodh anëtar i Kryesisë së Kosovës, ndërkaq më 1988, në fushatën e Serbisë kundër autonomisë së Kosovës, u përjashtua nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë. (Mrika Limani)

HAMZAJ Bardh (1960-2012). Gazetar. Lindi në Glllogjan të Deçanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim të viteve ‘80 punoi në gazetën studentore “Bota e re”, ku për një kohë ishte edhe kryeredaktor i saj. Në periudhën 1988-2009 punoi në javoren “Zëri i rinisë”, pastaj në javoren “Zëri” dhe në gazetën ditoren “Zëri”, në detyrën e gazetarit, redaktorit dhe të kryeredaktorit. Është autor i disa librave publicistikë: “Rrëfimin për luftën dhe lirinë” (1999) dhe “Paqja e gjeneralit” (2001), kushtuar komandantit të UÇK-së, Ramush Haradinaj, pastaj “Jasharët” (2003), ku rrëfohen përjetimet e kësaj familjeje gjatë luftës në Kosovë. Në vitet e fundit të jetës punoi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. (Artan Krasniqi)

HAN Johan Georg fon (Johan von Georg Hahn) (1811-1869). Gjuhëtar gjerman, albanolog, jurist dhe diplomat. Lindi në Frankfurt mbi Majn të Gjermanisë, studioi për drejtësi në Gisen dhe në Hajdelberg. Në vitet 1834-1843 punoi për Ministrinë e Drejtësisë së Mbretërisë së re Greke e më pas në vitet 1843-1847 ishte konsull prusian në Athinë dhe më pas zëvendëskonsull austriak në Janinë, ku ra në kontakt me shqiptarët dhe filloi të mësonte shqip. Më 1851 u emërua konsull austriak në



JOHAN GEORG
FON HAN

ishullin e Syrës. Sa qëndroi në Janinë, Hani bëri tri udhëtime në Shqipëri dhe mbledhi të dhëna për historinë, filologjinë dhe folklorin shqiptar. Ky material u botua në veprën e tij “Studime shqiptare” (Albanesische Studien) në tri vëllime, në Jenë më 1854. Në gusht-nëntor 1863 udhëtoi nga Durrësi dhe Shkodra nëpër lumin Drin për në Prizren, në Maqedoninë Perëndimore dhe që andej, duke kaluar luginën e Vardarit, në Selanik. Interesat e Hanit në Shqipëri dhe në Ballkanin Jugperëndimor ishin të shumëllojshme. Ekspedita e vitit 1863 rezultoi në një koleksion prej pesëdhjetë fotografish. Fushat kryesore të studimit shkencor të Hanit janë: historia, filologjia dhe folklori, në veçanti ato shqiptare, për të cilat ka ndërmarrë ekspedita hulumtuese shkencore në Shqipëri për t’i studiuar më hollësisht këto fusha dhe për t’ia paraqitur opinionit shkencor botëror. Në veprën e tij jepen vështrime gjeografike-etnografike për shqiptarët dhe vendin e tyre, jepen shënime nga udhëtimet e tij në Shqipëri (1848); skicohet një tablo etnografike e krahinave shqiptare, paraqitet historia e popullit shqiptar, jepen shpjegime për mitologjinë e shqiptarëve, flitet për alfabetin e shqipes. Veprat e rëndësishme të Hanit janë: “Studime shqiptare” (Albanesische Studien, Jenë, 1854), “Përralla greke dhe shqiptare” (Griechische und albanesische Märchen, Lajpcig 1864), “Udhëtim nga Beogradi në Selanik” (Reise von Belgrad nach Salonik, Vjenë, 1861 dhe “Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit” (Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar, Vjenë 1867/1869). (Mensur Vokri)

HANA Hyrije (1929-2004). Spikere, aktore, e persekutuar nga pushteti jugosllav. Lindi në Gjakovë. Më 1933 familja e saj shpëngulet në Shqipëri, prej nga kthehet sërish në Gjakovë



HYRIJE HANA

më 1941, ku vazhdon Gjinnazin Shqiptar të Gjakovës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte pjesëtare e lëvizjes së rinisë antifashiste dhe, më pas, bashkë me të ëmën, ia bashkua aradhjes partizane “Bajram Curri”. Njihet edhe si një nga spikeret e para të Radio Prizrenit dhe më pas të Radio Prishtinës. Ishte ndër aktoret e para të

Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë, bashkë me Meribane Shalën dhe Katarina Josipin. Në këtë teatër punoi me ndërprerje të herëpashershme, sepse për shkaqe politike u përjashtua nga puna dhe u burgos disa herë. Në periudhën 1953-1955 punoi si aktore në Teatrin e Pakicave (Drama Shqipe) në Shkup, ku luajti në shfaqjet: “E shoqja e Hasan Agës”, “Matura”, “Rruga rreth botës”, “Kryet e hudrës”, “Njerëzit”, “Zonja ministreshë”, “Bashkëshortët”, “Besa”, “Personi i dyshimtë” dhe “Koshtana”. Më 1955 kaloi si aktore në Teatrin e Mitrovicës. Atje u njoh me Ali Boletin, me të cilin martohet. Më 1955 u pranua sërish në Teatrin Popullor të Prishtinës. Në këtë teatër përgatiti shfaqjen “Koshtana”, por premiera e shfaqjes nuk u dha, sepse H. Hana u arrestua natën e premierës. Bashkë me të shoqin, Ali Boletin u mbajt në burg pa gjyq për dy vjet të tjera. Më 1961 u rikthye në Teatrin Popullor Krahinor, ku luajti rolin e profesores në shfaqjen “Matura”. Pas premierës dhe reprizës së parë u arrestua përsëri dhe u mbajt në burg deri më 1966, si anëtare e Organizatës “Lëvizja për liri dhe bashkim kombëtar”. Për herë të tretë u burgos më 1970, kur u akuzua se kishte kënduar këngë nacionaliste. Në vitet e fundit të jetës krijoi kukulla me veshje kombëtare, me të cilat hapi një ekspozitë në Galerinë e Arteve të Kosovës. Pas luftës së vitit 1999 u nderua me shumë mirënjohje dhe dekorata, si dhe u shkruan disa monografi për jetën dhe veprimtarinë e saj. Vdiq në Prishtinë. Pas vdekjes u botua libri i saj “Kujtime” (2008). (Naime Beqiraj, Haki Kasumi)

HANA Xheladin (1918-1948). Veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës, mësues, gazetar. Lindi në Gjakovë. Kreu gjinnazin në Shkodër dhe Normalen e Elbasanit. Mori pjesë në lëvizjen demokratike të rinisë shqiptare dhe u bë anëtar i Grupit Komunist të Shkodrës. Pas vitit 1941 u dërgua në Kosovë si mësues në Elshan dhe në Kijevë dhe u ngarkua nga Partia Komuniste Shqiptare për të organizuar atje Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më 1942 u burgos në Prizren. Pas lirimit mori pjesë në njësitin partizan “Bajram Curri”, që vepronte në Malësinë e Gjakovës. Ishte njëri nga hartuesit e dokumenteve të Konferencës së Bujanit. Pas luftës punoi gazetar në Radio dhe, një periudhë kohe, mësues në gjinnazin e Prishtinës, pastaj drejtor i gazetës “Rilindja” (1947). U angazhua dhe mbledhi të dhëna të ndryshme arkivale për

gjenocidin e jugosllavëve kundër shqiptarëve. U vra nga UDB-ja jugosllave më 15.12.1948 si informbyroist dhe nacionalist. (Izber Hoti)

HANADAN Reshit (1955-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Mamushë. Si fëmijë u shpërngul me familjen në Turqi më 1958, ndërsa më 1969 u kthye në Kosovë. Kreu degën e turkologjisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Më 1981 filloi punë në gazetën “Tan”, ku më pas drejtoi faqet e kulturës. Më 1998 shkoi në Turqi dhe punoi në gazetën “Zaman”. Nga viti 2009 është mesimdhënës në gjimnazin “Ataturk” të Mamushës. Botoi romane dhe libra me tregime: “Rob i ndjenjës” (1982), “Përmbytje” (1987), “Guri i rëndë në vend të vet” (2002), “Lamtumirë Perandoria e Sulltan Muratit” (2013), “Dola në rrugë nga Rumelia” (2015). Është shkrimtar i njohur edhe në Turqi, ku ka botuar disa tregime e artikujt në gazeta të ndryshme. Disa nga veprat e R. Handanit janë përkthyer edhe në shqip. (Irfan Morina)

HANET (shek. XVI-XIX). Ndërtime të arkitekturës popullore me funksion banimi, bujtina private, të cilat u ndërtuan dhe funksionuan kryesisht gjatë periudhës së Perandorisë Osmane. U ndërtuan pranë rrugëve të rëndësishme ose në qendra banimi. Ishin ndërtime nga materiali i dobët, prandaj nuk i bënë ballë kohës. Në Kosovë deri vonë ka pasur shumë ndërtime të këtilla, por sot kanë mbetur vetëm gjurmë të pakta të tyre. Hanet shërbenin për strehimin e mysafirëve, të cilët kalonin nëpër territorin e caktuar ose bënë vizita, për tregti ose për nevoja të tjera. Këtij dedikimi i shërbente edhe struktura arkitektonike dhe organizimi i hapësirave. Hanet ishin kryesisht godina dykatëshe, me oborr dhe anekse të tjera. Në shek. XVII, kur Evlia Çelebiu vizitoi Prishtinën, jep shënime për 11 hane në këtë qytet. Sot në Prishtinë ka ngelur vetëm një i tillë (ish-selia e vjetër e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve të Kosovës). Një ndër hanet që është ruajtur pothuajse në gjendjen fillestare është kompleksi i Hanit të Haraqive në Gjakovë, i cili u ndërtua në fund të shek. XVI. Hane kishin edhe në Pejë, siç ishte Hani i Sylejman Spahisë, i djegur gjatë luftës së vitit 1998/99. Si ndërtime të arkitekturës popullore, hanet ishin pjesë përbërëse e peizazhit urbanistik të qyteteve të vendit. (Orges Drançolli)

HANET DHE KARVANSARAJET NË KOSOVË. Vendet ku ndalonin udhëtarët apo tregtarët për pushim të shkurtër ditor apo për qëndrim disaditor. Të dyja këto emërtime kanë origjinë persiane, të sjellë në ambientin ballkanik nëpërmjet administratës osmane. Dallimi ndërmjet hanit dhe karvansarajit është i vogël dhe ai konsiston në faktin se udhëtarit në han paguante konakun, si dhe drurët për nxehtë gjatë dimrit, ndërkaq në karvansaraj konaku ishte pa pagesë, por për ushqim dhe nxehtë udhëtarit i duhej të përkujdesej vetë. Nga ana tjetër, në han kishte diçka nga orenditë (jorganë, enë për ujë dhe kafe, pajisje për ndriçim, vegla nallbanësh etj.), ndërkaq në karvansaraj nuk kishte gjëra të tilla. Hanet dhe karvansarajet u shfaqën që në dekadat e para të sundimit osman në Ballkan. Hanet e mëdha u ndërtuan përkrah vakëfeve të tyre nga administrues të lartë shtetërorë (sanxhakbejlerë, bejlerbejlerë, vezirë të mëdhenj etj.). Hanet e ndërtuara si vakëf rregullisht i jepeshin me qira hanxhiut. Karavansarajet patën një rol të rëndësishëm sidomos për qarkullimin e mallrave dhe për zhvillimin e tregtisë. Në sanxhaqet ballkanike kishte raste, kur ndonjë komunë kishtarë apo ndonjë përfaqësues i lartë i kishës ndërtonte një han dhe atë ia dhuronte kishës apo manastirit. Me kalimin e kohës, edhe disa tregtarë dhe njerëz të tjerë të pasur ngritën hane më të vogla, të cilat i jepnin me qira. Hane dhe karvansaraje kishte gjithandej trevave shqiptare, ndërkaq në Kosovë njihet hani i Xhamisë së Mazhiçit në Trepçë, i ndërtuar para vitit 1550; dy hanet e Sinan Pashë Topojanit të ndërtura para vitit 1586 në Kaçanik; katër hane të ndërtuar në Kaçanik nga Mehmet Pashë Kaçaniku në vitin 1600; Hani i Merre Hysein Pashës në Pejë (fillimi i shek. XVII) etj. Kurse ndër karvansarajet më të vjetra në Kosovë janë 14 karvansarajet e Mehmet Kukli beut në rrugën e Dukagjinit dhe të Stambollit. (Gazmend Rizaj)

HANI I ELEZIT. Qytezë dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës, afër kufirit me Maqedoninë, në rrugën Kaçanik-Shkup, ndërmjet bjeshkëve të Sharrit dhe Karadakut në lartësinë mbidetare 405 m. Emërtimi i parë i këtij vendbanimi Sar (Sharr) daton nga shekulli XVI. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se në këto hapësira edhe në kohën antike ishin të pranishme disa vendbanime, ndërsa banimi



HANI I ELEZIT

i hershëm i kësaj zone është kushtëzuar dhe ndikuar nga pozita gjeografike, si një kapërcyell në rrugën e rëndësishme që lidhte Kosovën me Shkupin. Emërtimin e sotshëm e mban që nga shek. XIX, sipas një pronari të një bujtine. Udhëtimi dhe transporti i mallrave përmes grykës së Kaçanikut ishte gjithmonë i vështirë, por hani ofronte vendpushim dhe lehtësim për udhëtarët e kohës. Në vitin 2011 kishte 2,533 banorë, ndaj 369 banorëve sa kishte në vitin 1948. Është qendër administrative komunale, në të cilën gravitojnë 11 vendbanime. Është pikë kufitare ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë, me qarkullim të madh të njerëzve dhe mallrave, por edhe me industri të zhvilluar dhe me rëndësi për Kosovën. Është i njohur për eksploatimin e shkëmbinjve dhe prodhimin e çimentos. Ka Fabrikën e Çimentos dhe një numër objektesh të infrastrukturës arsimore, shëndetësore, pastaj disa njësi tregtare, zejtare, shërbyese etj. (Përparim Gashi)

HANI I ELEZIT (komuna). Komunë në pjesën juglindore të Kosovës me qendër qytezën me të njëjtin emër. Në veri kufizohet me komunën e Kaçanikut, ndërsa në pjesët e tjera kufizohet me Maqedoninë. Shtrihet ndërmjet maleve të Sharrit dhe Karadakut, kurse gryka e Kaçanikut e ndan territorin e komunës në dy pjesë. Nëpër të kalojnë dy linja të rëndësishme rrugore: magjistrala Prishtinë-Shkup dhe hekurudha Fushë Kosovë-Shkup-Selanik, që të dyja me karakter ndërkombëtar. Këto dy segmente të komunikimit e bëjnë Hanin e Elezit urë lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë. Nëpër territorin e kësaj komune rrjedh lumi Lepenc, në drejtim të Maqedonisë, me vëllim prej 8 m³/sec, ndërsa në të dy anët e shpateve rrjedhin shumë përrenj, të cilët i japin gjallëri kësaj

hapësire. Klima është kontinentale, me dimra të ashpër, me temperaturë minimale -10°C dhe vera të nxehta, me temperaturë maksimale deri në 40°C. Territori i komunës zë sipërfaqen prej 83 km², nga e cila 3,895 ha janë ara, 3,878 ha pyje, 1,693 ha kullosa dhe 230 ha livadhe. Kultivohen kryesisht drithërat, perimet dhe pemët. Në territorin e kësaj komune jetojnë 9,043 banorë në 11 vendbanime, me dendësi mesatare të popullsisë prej 113 b/km². (Përparim Gashi)

HAPÇIU Kelmend (1955-). Gazetar. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor, ndërsa gjimnazin dhe studimet për gjuhë angleze i kreu në Prishtinë. Punën e gazetarit e nisi në vitet '80 në gazetën e përditshme "Rilindja", ku mbuloi sektorë të ndryshëm, përfshirë raportimin nga forumet e larta politike të asaj kohe. Pas mbylljes së "Rilindjes" nga Serbia më 1990 kreu detyrën e redaktorit të politikës së jashtme në gazetën "Bujku". Ka qenë gjithashtu redaktor-kolumnist në revistën "Koha", ndërsa pas luftës, në vitin 2000, themeloi dhe drejtoi agjencinë e pavarur të lajmeve "Kosova Live". Një kohë ka qenë drejtor menaxhues në Institutin e Medies të Kosovës, si dhe një prej trajnerëve të gazetarëve në këtë institut. Përktheu nga gjuha angleze në gjuhën shqipe librat "Toka në baraspeshë" të autorit Al Gore dhe "Mbi Lirinë" e Xhon Stjuart Millit. (Artan Krasniqi)

HAPÇIU Mjellma (1978-). Grafiste. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në Prishtinë, ku kreu dhe studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve (2002). Është pjesëmarrëse në disa e ekspozita të përbashkëta, si në Sallonin e Nëntorit në Galerinë e Arteve të Kosovës (2002), në Sallën e Ekspozitave në Luksemburg (Salle dexposition du Luxembourg, 2002), në Muzeun e Kosovës me rastin e 12 Qershorit, Ditës së Prishtinës (2003), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës etj. Ka fituar çmime dhe mirënjohje për punë artistike. Shquhet për trajtat me motive nga bota organike, të materializuara në teknikën grafike të akuatintës. (Basri Mekolli)

HARADINAJ Daut (1978-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Brigadës 131 "Jusuf Gërvalla" të UÇK-së. Lindi në fshatin Glllogjan, komuna e Deçanit. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në



DAUT HARADINAJ

Irzniq të Deçanit. Në vitin shkollor 1997/1998 u regjistrua në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, por për shkak të rrethanave të luftës dhe angazhimit në radhët e lëvizjes, nuk i vazhdoi ato. Pas përfundimit të luftës kreu

studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishte njëri ndër tre luftëtarët e radhëve ilegale të UÇK-së, i cili së bashku me Mujë Krasniqin e Rexhep Selimin e bënë publike Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, më 28 nëntor 1997 në varrimin e mësuesit Halit Geci, në Llaushë të Drenicës. Gjatë viteve 1997-98 disa herë udhëtoi për në Shqipëri me grupet e furnizimit me armë për UÇK-në. Mori pjesë edhe në aksione të shumta të kryera kundër postëkomandave të forcave serbe. Beteja e Glllogjanit, kur u sulmua familja Haradinaj më 24 mars 1998, shënoi fillimin e luftës frontale në Rrafshin e Dukagjinit. Pas kësaj beteje, D. Haradinaj u caktua përgjegjës i vijave të frontit në rajonin e Deçanit. Njëkohësisht u mor me stërvitjen luftarake të pjesëtarëve të rinj të UÇK-së në Shtabin e Zonës Operative (ZO) të Dukagjinit në Glllogjan. Mori pjesë në të gjitha betejat që u zhvilluan gjatë luftës në ZO të Dukagjinit. Në ofensivën e gushtit '98, në Gramaçel u plagos rëndë. U plagos edhe disa herë të tjera në betejat e zhvilluara. Pas ofensivës së shtatorit u emërua zëvendëskomandant i batalionit "Dukagjini". Nga kjo njësi, brenda një kohe të shkurtër arrijnë të zhvillohen tetë brigada. Në nëntor të vitit 1998, D. Haradinaj u emërua komandant i Brigadës 131 "Jusuf Gërvalla" të UÇK-së, e caktuar për operim në territorin e komunës së Deçanit. Pas përfundimit të luftës, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e gradoi me gradën gjeneralmajor. Më 20 shtator 1999 D. Haradinaj u emërua zëvendëskomandant i Zonës së Tretë të TMK-së, ndërsa në vitin 2000 u avancua në detyrën e komandantit të Zonës së Tretë të Mbrojtjes. Në qershor të vitit 2001 u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së. Në dy mandate u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). (Fetnete Ramosaj)

HARADINAJ Himë (1981-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK),

dëshmor. Lindi në fshatin Glllogjan të komunës së Deçanit. Në radhët e UÇK-së u angazhua pa i mbushur 16 vjet, në maj të vitit 1997. Për shkak të moshës së re ishte i angazhuar me detyra të vëzhgimit, të furnizimit dhe informimit rreth lëvizjes së forcave serbe në fshat. Fillimi i luftimeve më 24 mars 1998 H. Haradinajn, bashkë me babanë e tij, Rasimin, i gjeti në shtëpinë e tyre. Atë ditë nxënësit e shkollës fillore "Hasan Prishtina" të Glllogjanit ishin marrë peng nga forcat serbe, për t'i përdorur si mburojë gjatë lëvizjeve në fshat. H. Haradinaj, së bashku me Gazmend dhe Agron Mehmetajn u dalin në ndihmë nxënësve, por H. Haradinaj u qëllua nga forcat serbe. Me këtë rast u plagos rëndë, më pas u tërhoq në drejtim të maleve të fshatit Shaptej, ku ndërroi jetë nga plagët e marra. (Fetnete Ramosaj)

HARADINAJ Luan (1973-1997). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Glllogjan të komunës së Deçanit. Ishte fëmija i tretë i Hilmi dhe Ruke Haradinaj. Ende pa i mbushur 20 vjet, ishte ndër ushtarët e parë të UÇK-së. Që nga viti 1991 u angazhua për sigurimin e armatimit dhe organizimin e luftës së armatosur. Në fillim të vitit 1993 formoi celulat e para të UÇK-së në rajonin e Dukagjinit. Nga fillimi i vitit 1994 kreu detyrën e shefit të sektorit të logjistikës të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për furnizim me armatim nga Shqipëria. Bashkëveproi dhe luftoi së bashku me të gjithë luftëtarët dhe komandantët më në zë të UÇK-së. Ishte ndër drejtuesit më të përgatitur të gueriles së UÇK-së. Kreu mbi 30 aksione guerile kundër postëkomandave të policisë e të ushtrisë serbe, si në Irzniq, Baballoç, në postëkomandat e ushtrisë serbe përgjatë brezit kufitar etj. Më 6 maj 1997, së bashku me një grup bashkëluftëtarësh, në mesin e të cilëve gjendej edhe vëllai i tij, Ramushi, me Fehmi e Xhevë Lladrovcin, Selim Krasniqin, Abedin Rexhën, Iljaz Kodrën, Ramiz Lladrovcin etj., kaluan kufirin e Shqipërisë, me synim që të hyjnë në Kosovë. Grupit i printe Luan Haradinaj. Në afërsi të Kushninit të Hasit, në Qafë Mullar u ndeshën në pritën e forcave serbe. Në këtë përballje me forcat serbe ra L. Haradinaj. Në vitin 2008 nga presidenti i Kosovës u dekorua me Urdhrin "Hero i Kosovës", ndërsa me rastin e 7-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, presidenti i Republikës së Shqipërisë ia ndau dekoratën "Nderi i Kombit". (Faton Mehmetaj)

HARADINAJ Ramush (1968-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, lider i partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Një



RAMUSH
HARADINAJ

ndër komandantët më të njohur dhe më të suksesshëm të UÇK-së. Lindi në fshatin Glllogjan të komunës së Deçanit. Për shkak të përndjekjeve policore, që në fillim të viteve '90 u detyrua të emigrojë në Zvicër, ku jetoi për afro 8 vjet, duke kryer punë të rëndomta. U përfshi në lëvizjen ilegale të kohës, duke u përcaktuar që nga fillimi për luftë të armatosur. Bashkë me të vëllanë Luanin, ishte njëri nga luftëtarët e radhëve të para të UÇK-së, të cilët operuan në terren. Gjatë viteve 1996-1997 Haradinaj mori pjesë në organizimin e njësive të UÇK-së në fshatrat kufitare shqiptare, si: Kukës, Morinë, Tropojë, Vlanë etj. Më 1998 u emërua komandant i Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit (më vonë Zonës Operative të Dukagjinit). Gjatë luftimeve u plagos disa herë: në betejën e 6 majit 1997, në betejën e 24 marsit 1998 në Glllogjan, në betejën në Carrabreg (qershor 1998) etj. Sulmin e parë frontal në rajonin e Dukagjinit forcat okupuese serbe e ndërморën në Glllogjan, për likuidimin e familjes Haradinaj më 24 mars 1998, vetëm disa ditë pas sulmit të ndërmarrë kundër familjes Jashari në Prekaz të Drenicës. Nën drejtimin e R. Haradinajt, i cili ishte plagosur rëndë, luftëtarët e UÇK-së arritën ta fitojnë këtë betejë, pas shumë orë luftimesh me forcat policore dhe ushtarake serbe. Gjatë gjithë luftës ai drejtoi me sukses dhjetëra beteja në gjithë rajonin e Dukagjinit. Pas luftës, me transformimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), u emërua zëvendëskomandant i TMK-së, me gradën e gjeneralmajorit. Në prill të vitit 2000 u largua nga jeta ushtarake dhe themeloi partinë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), si dhe u zgjodh kryetar e saj. Më 3 dhjetor 2004 u zgjodh kryeministër i Kosovës, në një koalicion me LDK-në. Më 8 mars të vitit 2005 Tribunali për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi ngriti aktakuzë ndaj tij dhe po atë ditë R. Haradinaj dha dorëheqje nga pozita e kryeministrit të Kosovës, për t'u dorëzuar

vullnetarisht në Tribunalin e Hagës. Procesi gjyqësor kundër tij, në të dy shkallët, zgjati për afro 8 vjet dhe, në përfundim të tij, u shpall i pafajshëm nga të gjitha akuzat e ngritura nga prokuroria e Tribunalit të Hagës. Me t'u kthyer nga Haga, vazhdoi riorganizimin e AAK-së. Në zgjedhjet parlamentare (2014) u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. Në vitin 2012, për meritat e treguara në luftë për liri, presidenti i Shqipërisë e nderoi me Urdhrin "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". (Fetnete Ramosaj)

HARADINAJ Shkëlzen (1970-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Glllogjan të Deçanit. Ishte fëmija i dytë i Hilmi dhe Ruke Haradinajt. U



SHKËLZEN
HARADINAJ

inkuadrui në radhët e UÇK-së prej vitit 1993. Bashkëveproi në kuadër të njësitit të UÇK-së me vëllezërit e tij, Ramushin e Dautin dhe u mor me furnizimin me armë dhe me kryerjen e aksioneve guerile. Gjatë vitit 1997, pas rënies së vëllait të tij, Luanit, merr përgjegjësinë kryesore të bartjes së armatimit nga Shqipëria dhe për përcjelljen e ushtarëve nga njëra anë e kufirit në tjetrën. Mori pjesë në organizimin e aksionit të 11 shtatorit të vitit 1997, i kryer njëkohësisht kundër vendqëndrimeve të policisë serbe në 14 vende të Kosovës. Në mars të vitit 1998, pas sulmit mbi familjen e Adem Jasharit në Prekaz dhe mbi popullatën në fshatrat Çirez e Likoshan të Drenicës organizoi një aksion të përgjithshëm, me çrast brenda 24 orësh në rajonin e Dukagjinit u kryen mbi 22 aksione të armatosura kundër vendqëndrimeve të forcave policore dhe ushtarake serbe. U plagos rëndë disa herë. Mori pjesë në betejën e parë frontale më 24 mars 1998 në Glllogjan. Gjithashtu mori pjesë në mbrojtjen e vijës së frontit në Baballoq dhe në Gramaçel më 21 prill. Në betejën e Baballoqit u plagos rëndë. Pas shtatorit të vitit 1998, me riorganizimin e Zonës Operative të Dukagjinit, u emërua ndihmëskomandant për mbrojtjen territoriale dhe më pas ndihmëskomandant për operacione luftarake të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit. Ishte përgjegjës i vijave të frontit në Ratish të Epërme e Dashinoc, ku me bashkëluftëtarët e

Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla” dhe të Brigadës 134 “Bedri Shala” përballuan me sukses sulmet e forcave serbe. Në betejën e zhvilluar në këtë vijë të frontit, që zgjati nga 9-18 janar 1999, u plagos përsëri. Luftoi edhe në betejën e Pozharit (27-2 prill 1999), ku forcat serbe u thyen dhe u detyruan të tërhiqen. Më 5 prill 1999 drejtoi operacionin për evakuimin e mbi 40 luftëtarëve të plagosur nga Zhebeli në drejtim të Istogut. Më 16 prill ra dëshmor në një rën ndër betejat më të rrepta në malet e Maznikut. Në vitin 2011 presidentja e Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Faton Mehmetaj)

HARF Arnold fon (von Harff) (1417-1505). Pelegrin, kalorës. Autor i dokumentit të dytë të historisë së shkrimit shqip. Lindi në Këln të Gjermanisë. Nga viti 1496 deri më 1499 udhëtoi në Itali, Siri, Egjipt, Arabi, Etiopi, Nubi, Palestinë, tokat e pushtuara nga Perandoria Osmane, në Francë dhe në Spanjë. Në kuadër të udhëtimit të tij si pelegrin, në vitin 1497, përshkroi bregdetin e Shqipërisë: Ulqinin, Durrësin dhe Sazanin. Shënoi 26 fjalë shqip, 8 shprehje, numrat 1 deri 10 dhe numrat 100 dhe 1000. Shënoi fjalët: ujë, verë, bukë, mish etj. Dorëshkrimi i tij u zbulua në vitin 1860 në Këln. Po këtë vit u botua një libër i tërë me shënime edhe për popujt e shteteve të tjera që i kishte vizituar. (Ganimet Klaiqi)

HARTA E AL IDRISIT. Hartë mesjetare e botës, e përfunduar në vitin 1154. Autori i kësaj harte ishte gjeografi arab Muhammed Al-Idrisi (1099-1166) i lindur në Ceuta të Afrikës Veriore. Al-Idrisi u shkollua në Kordoba të Spanjës, e cila atëbotë ishte nën sundimin e arabëve. Më vonë jetoi dhe veprroi në oborrin e mbretit Roxher në Sicili, ku shkroi veprën më të rëndësishme për gjeografinë e botës, të njohur deri më atëherë. Për nder të Roxherit, hartën e quajti “Tabula Rogeriana”. Harta kishte përmasa 3.42×1.48 m, dhe më vonë, sipas saj, është riprodhuar një kopje në pllakë argjendi. Sot harta burimore nuk ekziston, por ruhen kopjet e punuara sipas modelit të saj. Krahas hartës, Al-Idrisi e shkroi edhe një libër përcjellës, i cili shërbente si komentues i hartës (“Kitab al Rudjar”). Në “Tabula Rogeriana” përmenden gjithsejtë 2,500 emra gjeografikë, ndërsa “Kitab al Rudjar” përmban rreth 7,000 terma gjeografikë. Të gjitha emërtimet janë shkruar në



gjuhën arabe, gjë që edhe sot paraqet vështirësi në leximin dhe identifikimin e tyre. Harta është e ndarë në shtatë zona klimatike dhe, përveç të dhënave botërore, ofron informacione të rëndësishme edhe për Ballkanin, përkatësisht për Shqipërinë, Maqedoninë, Dalmacinë etj. Al-Idrisi në vargun e qyteteve të rëndësishme përmend Lezhën (Lessu), e cila shtrihet në majë të një kodre me të njëjtin emër. Duke përshkruar territoret shqiptare, Al-Idrisi përmend malin e Tomorit (el Tamura) dhe qytetin e Durrësit. Këtu rrjedhin edhe lumenjtë, që shkojnë drejt Vlorës (Labluna) dhe Durrësit (Drast). Lumi i parë është ai i Vlorës, i quajtur Shuzza (Vjosa), i dyti është quajtur Dâblî (Devoll), si dhe i treti quhet Istrîna (Drini). Largësia nga Durrësi deri në Jâdhra (Zara) sipas Al-Idrisit është 40 milje. Për Lezhën thotë se shtrihet 15 milje larg nga Durrësi, ndërsa nga Lezha deri në Ulqin (Dulina) shkruante se ka 30 milje. Al-Idrisi shkruan se ndërmjet Durrësit dhe Konstandinopojës shtrihen vende të rëndësishme, qytete dhe kryeqytete. Sipas tij, nëse nga Durrësi udhëtojmë nëpër tokë në drejtim të Konstandinopojës, qyteti i parë është Petrela, e vendosur në një kep në distancë prej dy ditësh. Që atje, në distancë prej katër ditësh shtrihet Ohri (Okhrida). Këtë qytet ai e përshkruan të pasur dhe jo shumë larg nga një liqen i madh. Dy ditë udhëtim nga aty, sipas tij, mbërrihet në Bulghu (Pollog/Tetovë), qytet që ndodhet në majë të një mali të lartë. Duke vazhduar itinerarin nga këtu për në Konstandinopojë, Al-Idrisi vë në dukje se: “...nëse nga

këtu udhëtojmë në drejtim të verilindjes në një distancë kohore njëditore, do të arrijmë te Asqafia (Shkupi), një qytet i madh i rrethuar me shumë vreshta dhe fusha”. (Muhamet Mala)

HARTA E BOTËS E FRAT MAURIT. Harta e parë e klerikut dhe hartografit venedikas Frat Mauro është e vitit 1450. Harta kishte formën rrethore dhe është e vizatuar në pergamenë



me kornizë druri, me dimensione shumë të mëdha 2.4 x 2.4 m. Është e orientuar në drejtim të jugut. Për përpilimin e hartës janë përdorur burime të sigurt, e jo siç ishte zakoni deri atëherë, kur hartografit shërbeheshin me të dhëna të paverifikuara. Në hartë janë përfshirë Azia, Oqeani Indian, Afrika, Europa dhe Atlantiku. Orientimi i hartës paraqet jugun në pjesën e epërme të hartës. Harta përmban me qindra vizatime të detajuara dhe rreth 3,000 tekste deskriptive. Ishte harta më e detajuar dhe më reprezentative e prodhuar deri në atë kohë. Nga Ballkani përgjithësisht dhe Arbëria në veçanti, përmenden rrugët që lidhnin bregdetin shqiptar me hinterlandin, si dhe rruga e njohur publike që lidhte Prishtinën (Pristina) me Novobërdën (Noua Barda). Sipas një gravure nga viti 1737, Frat Mauri ishte autor i një harte të punuar në Istria, sipas së cilës autori zotëronte njohuri të hollësishme për bregdetin Adriatik, si dhe për qytetet e prapatokës, të cilat ruanin marrëdhënie të mira me bregdetin. Vend të rëndësishëm këtu zinte Novobërda, si qendër e njohur me xeherore të pasura të arit

dhe të argjendit. Po ashtu përmendet këtu edhe Peja (Forno) në trajtën e gjuhës italiane. (Muhamet Mala)

HARTA E GADISHULLIT BALLKANIK (1444). Hartë ushtarake e Gadishullit Ballkanik, pjesë e një manuskripti latin, që gjendet në Bibliotekën Nacionale të Francës. I takon shekullit XV, sipas të gjitha gjasave, vitit 1444. Pjesa më e madhe e manuskriptit është një tekst i përcjellë me ilustrime nga Paolo Santini, një inxhinier dhe arkitekt ushtarak italian, i punësuar në Mbretërinë e Hungarisë nga mesi i shek. XV. Harta u përpilua për nevoja të ushtrisë hungareze, në kohën kur ekspansioni i Perandorisë Osmane po i kërcënonte seriozisht kufijtë jugorë të këtij shteti. Në hartë është paraqitur raporti i forcave ushtarake të krishtera dhe osmane në prag të Betejës së Varnës (10 nëntor 1444). Kjo hartë, përveç vlerave të saj nga historia ekonomike e Kosovës, spikat edhe rëndësinë strategjike të këtij vendi në kontekstin ballkanik. Aty veçohen sidomos qytetet e fortifikuara, të cilat zotëronin flamuj përkatës. Fortifikata që mbante flamurin me gjysmëhënë konsiderohej e pushtuar nga osmanët, ndërsa ato me kryq ishin fortifikata të papushtuara. Në këtë kuadër shquhet sidomos Novobërda, e cila si qytet i rëndësishëm xehetar dhe me kështjellën e saj shumë të fortifikuar llogaritej të kishte një rol vendimtar në luftën antiosmane. (Gazmend Rizaj)

HARTA FIZIKO-GJEOGRAFIKE. Hartë komplekse me paraqitje të morfologjisë së terrenit dhe të hidrografisë. Harta fiziko-gjeografike punohet në shkallë (përpjesë), varësisht nga madhësia e letrës. Për shkak të shkallës së hartës, lartësia e terrenit paraqitet me shkallë hipsometrike me ngjyra, izohipse etj. Harta plotësohet me elemente të tjera: kuotat, vendbanimet e mëdha, rrugët kryesore etj. Në kuadër të hartave fiziko-gjeografike hyjnë: harta gjeologjike, gjeomorfologjike, meteorologjike, klimatike, hidrologjike, sizmologjike, gjeofizike, pedologjike, zoologjike, botanike etj. Në të kaluarën hartat fiziko-gjeografike të Kosovës janë punuar në kuadër të hartës së ish-Jugosllavisë, ose si të veçanta. Pas vitit 2000, kompania Beak (Gjermani), në bazë të hartave dhe materialeve ekzistuese, ka përpiluar dhe botuar një komplet hartash të sintetizuara e të digitalizuara, ndër të cilat edhe

hartën fiziko-geografike të Kosovës në shkallë 1:200,000 (harta morfo-orografike), ku janë të paraqitur në mënyrë të detajuar morfologjia (malet, fushat) dhe hidrografia e saj. (Valbon Bytyçi)

HARTAT TEKTONIKE. Hartë që paraqet arkitekturën e strukturës të pjesës së sipërme të kores së Tokës ose pjesëve të saj dhe zhvillimin e tyre në etapa tektonike të caktuara, duke pasqyruar morfologjinë, historinë e formacioneve të strukturave tektonike, fazat e zhvillim të tyre dhe marrëdhëniet e magmatizmit me tektonikën. Në hartën tektonike janë të përgjithësuara të dhënat faktike mbi veçoritë dhe ligjësitë e elementeve strukturore të korës së Tokës, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes i rëndësishëm në njohjen e çështjeve të përgjithshme të tektonikës dhe gjeologjisë në përgjithësi, por edhe për hulumtimin e mineraleve të dobishme, ujërave nëntokësore gjeotermale, në gjeoteknikë etj. Sipas përmbajtjes, përveç skemave e hartave tektonike të përgjithshme (standarde) ekzistojnë edhe harta të veçanta tektonike, siç janë harta strukturore, paleotektonike, sizmotektonike, neotektonike etj. Ndërtohen në shkallë të ndryshme të zvogëlimit, nga ato të përgjithësuarat deri në hartat e detajuara. Në të kaluarën, pasqyrimet tektonike të territorit të Kosovës janë paraqitur në kuadër të skemave dhe hartave tektonike të Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë. Pas vitit 2000, nga ana e Beak Company-së (Gjermani), duke shfrytëzuar materialet ekzistuese, është përpiluar një hartë e sintetizuar tektonike e Kosovës në shkallë 1:200,000, e publikuar nga KPMM-ja. (Vahdet Pruthi)

HARTAT GJEOLGJIKE. Harta që pasqyrojnë në mënyrë grafike në një shkallë të caktuar ndërtimin gjeologjik të një pjese të sipërme të kores së Tokës, përkatësisht të një treve ose të një shteti dhe që shërbejnë si bazë për hulumtimet e mineraleve të dobishme, për hulumtimet gjeoteknike, të ujërave nëntokësore, geomjedis etj. Ka harta gjeologjike të përgjithshme (komplekse), që paraqesin përbërjen, moshën, mbërthimin strukturor-tektonik të shkëmbinjve dhe formacioneve gjeologjike, të shoqëruara me tekstin sqarues, si dhe harta gjeologjike speciale (të veçanta), si harta e mineraleve të dobishme, gjeologo-inxhinierike, hidrogjeologjike, tektonike e neotektonike, paleogjeo-

grafike, gjeokimike, gjeofizike (magnetike, sizmike etj), faciale, strukturore etj.

Hartat gjeologjike për territorin e Kosovës në të shumtën e rasteve janë përgatitur dhe botuar në kuadër të hartave gjeologjike të Serbisë ose të ish-Jugosllavisë, siç janë hartat gjeologjike, tektonike, metalogjenike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, sizmike etj., në shkallë 1:500,000 dhe harta gjeologjike e Serbisë në shkallë 1:200,000. Harta gjeologjike e parë e botuar vetëm për territorin e Kosovës është ajo e realizuar nga ana e Industroprojekt-it të Zagrebit, e vitit 1974 në shkallë 1:100,000. Në kuadër të projektit disavjeçar për përpilimin e hartës gjeologjike të ish-Jugosllavisë, është mbuluar me rilevim edhe territori i Kosovës, në shkallë 1:25,000 dhe janë përpiluar dhe botuar nga Instituti Gjeologjik Federativ i ish-Jugosllavisë, planshetat e hartës gjeologjike 1:100,000 me tekstet sqaruese përcjellëse. Pas vitit 2000, Kompania Beak (Gjermani), në bazë të hartave dhe materialeve ekzistuese, ka përpiluar dhe botuar një komplet hartash të sintetizuara e të digjitalizuara si harta gjeologjike, tektonike, të mineraleve të dobishme, hidrogjeologjike, të ujërave termominerale etj. të Kosovës, në shkallë 1:100,000 dhe 1:200,000. (Vahdet Pruthi)

HARTAT SIZMIKE. Harta në të cilat paraqitet veprimtaria e tërmeteve në rajon të caktuar, fuqia e të cilëve është vlerësuar në ballë (sipas shkallës MSK-64, EMS-98 etj.), magnitudë (sipas shkallës Rihter) ose në parametra të tjerë sizmik. Hartat e rajonizimit sizmik, të cilat në fakt janë harta të rrezikut sizmik në shkallë rajonale, paraqesin ndarjen e një territori në zona të konturuara sipas intensitetit sizmik të pritshëm të lëkundjeve të truallit në kohë të caktuar, në formë të nxitimit (cm/sek^2), të shpejtësisë (cm/sek) dhe të zhvendosjeve (cm), si dhe të intensitetit në shkallën e ballëve, me një probabilitet të dhënë. Në kuadër të hartës sizmologjike të ish-Jugosllavisë (1987), është bërë rajonizimi sizmik edhe i territorit të Kosovës, i shprehur me intensitet (në ballë) dhe nxitim (në g), me një probabilitet prej 63% dhe periudha të përsëritjes së tërmeteve për 50, 100, 500, 1.000 dhe 10.000 vjet për truall mesatar. Harta sizmike e intensiteteve maksimale të pritshme, me periudhë të përsëritjes prej 500 vitesh, edhe në Kosovë ka shërbyer për qëllime të ndërtimit sipas Eurokodit 8. Hartat e para

të rrezikut sizmik (intensitet dhe nxitim), të përpiluara posaçërisht për Kosovën janë realizuar me një studim në vitin 1985, ndërsa më vonë janë përpiluar harta të tjera (me paraqitje të nxitimit), në bazë të një studimi të realizuar në vitin 2009. Këto të fundit tregojnë se pjesa më e madhe e territorit të Republikës së Kosovës mund të konsiderohet si zonë me rrezik sizmik mesatar ($0,10g < PGA < 0,22g$). Nxitimi horizontal maksimal i truallit (PGA), në kondita shkëmb i fortë, me 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (periudhë përsëritjeje 475 vjet) lëkundet nga 0,10g në pjesën verilindore të vendit, deri në 0,20-0,22g në veri dhe jug të Kosovës. Për disa pjesë të Gjilanit dhe Prishtinës është bërë edhe mikrozonimi sizmik, përkatësisht përcaktimi i rrezikut sizmik, në varësi të kushteve konkrete lokale të truallit, zonim i domosdoshëm për të ndërtuar në zonat me intensitet të lartë sizmik. (Fidaim Sahiti)

HASANAGIQ-NIMANBEGU Vahida (1973-).

Piktore. Lindi në Tivar (Mali i Zi). Kreu shkollën e mesme në vendlindje, kurse pikturën monumentale e studioi në Fakultetin e Arteve Aplikative në Beograd (2002). Është anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Malit të Zi. Mbajti disa ekspozita individuale në Ulqin më 1999, në Cetinë më 2007, po në të njëjtin vit në Beograd e Podgoricë etj. Mori pjesë edhe në një sërë ekspozitash kolektive në Beograd (1999, 2000, 2006), pastaj në Ulqin, në Hotelin "Albatros" (2004) dhe në Galerinë e Kullës së Balshajve (2006). Frymëzohet kryesisht nga motivet e ambientit të Ulqinit. Pikturën e saj e shquajnë ngjyrat dhe vijat e një shprehjeje lirike. (Rexhep Ferri)

HASANAJ Gjergj (1933-1978). Mbledhës i folklorit. Lindi në Triesh të Malësisë së Madhe. Shkollimin fillor e kreu në Tuz, ndërsa Shkollën Normale dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1961). Punoi si mësues në Triesh të Epërm. Në vitin 1972 emigroi në SHBA, ku jetoi dhe veproi deri më 1978, kur e humbi jetën tragjikisht në Detroit. Gjatë punës si mësues u mor me mbledhjen e folklorit në Malësi të Madhe dhe në trojet e tjera shqiptare në Mal të Zi. Në vitin 1971 botoi veprën vëllimore "Malësori këndon" (1971), një përmbledhje këngësh popullore historike, të vajtimeve dhe gjëmave të rralla dramatike me vlerë për folkloristikën shqiptare. (Ylberza Halili)

HASANGJEKAJ Beqir (1936-). Trajner i hendbollit, mësimdhënës. Lindi në Martinaj të komunës së Plavës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Guci, Normalen në Prishtinë,



BEQIR
HASANGJEKAJ

në, ndërsa u diplomua në Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd (1964). Punoi në Prizren dhe në Mitrovicë dhe së fundi në Entin Komunal për Përparimin e Arsimit në Prishtinë. Në vitin 1985 u zgjodh ligjërues për lëndën e metodikës në Fakultetin e Kulturës Fizike (tash të Shkencave Sportive) dhe më vonë për lëndën e didaktikës kineziologjike deri në vitin shkollor 2002/03, kur u pensionua. Që nga viti 1953 e deri në shtator të vitit 1958 ka qenë lojtar i klubit të hendbollit "Normalisti", kampion i pesëfishtë i Kosovës. Në vitin 1958 redaksia e sportit e gazetës "Rilindja" e shpall ndër 10 sportistët më të mirë të Kosovës. Po në atë vit bëhet anëtar i KH "Partizani" të Beogradit, për të qenë hendbollisti i parë shqiptar që bëri gara në ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Ka luajtur edhe për KH "Prizreni" dhe KH "Trepça". Nga viti 1964 ishte trajner në "Prizren", "Trepçë", "Prishtinë" (femrat dhe meshkujt) dhe KH "Universiteti". Suksesin më të madh e ka arritur me inkuadrimin e KH "Prishtina" (femrat) në ligën e parë B federative të ish-Jugosllavisë. Në vitin 2004 mori çmimin e trajnerit më të suksesshëm të Kosovës. Kreu detyra të ndryshme në asociacionet sportive të Kosovës, pastaj ishte redaktor i revistave profesionale-shkencore "Acta Kineziologica" dhe "Eurosporti". Ka botuar një varg librash dhe punimesh profesionale e shkencore dhe tekstesh universitare ("Metodika e edukatës fizike"). (Xhavit Kajtazi)

HASANI Avdush (1950-1994). Aktor. Lindi në Pakashticë të Podujevës. Studimet për akttrim i mbaroi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Nga viti 1971 u bë pjesëtar i ansambllit të Teatrit Popullor të Kosovës, ku realizoi një mori rolesh kryesore në shfaqjet: "Verbimi i Samsonit" (1982), "Gjërat që s'preken" (1982), pastaj "Vdekja më vjen prej syve të tillë" (1989), "Zhvarrimi i Pjeter Bogdanit" (1991) etj. Realizoi me sukses edhe role në shfaqjet "Dasma e përgjakur" "Beselam pse më flijojnë", "Trungu ilir", "Gof", "Shpend Sokoli i Sokol



AVDUSH HASANI

Shpendit”, “Ifigjenia në Aulidë”, “Zogu i diellit”, “Bregu i pikëllimit”, “Dasma e përgjakur” etj. A. Hasani ishte aktor me rrezatim ekspresiv në skenë, me diksion të pastër, i cili krijonte relacion të pashkëputur mes fjalës dhe heshtjes, gjë

që lojën e tij e bënte sugjестive. Pos në teatër, aktrioi role edhe në filmat: “Njeriu prej dheu” të A. Sopit, “Gjurmët e bardha” të E. Kryeziut dhe “Pikniku” të E. Halilit. Gjatë viteve ‘90, kur në Teatrin Popullor Krahinor u vendosën masa të dhunshme, A. Hasani u largua nga Kosova. Vdiq në Zvicër. (Fadil Hysaj)

HASANI Bekim (1976-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Ferizaj, studimet për gazetari në Fakultetin e Gazetarisë të Universitetit të Tiranës. Punën prej gazetari e nisi në vitin 1999, në botimin e Tiranës të gazetës “Rilindja”. Më pas ka punuar gazetar në të përditshmen “Dita” në Prishtinë dhe gazetar e redaktor në Radiotelevizionin e Kosovës. Një kohë ishte redaktor në agjencinë e lajmeve “Kosova Live”. Në periudhën 2010-2013 ishte drejtor i Televizionit të Kosovës, ndërsa nga viti 2013 ishte anëtar i Bordit të Unionit Ndërkombëtar të Radiotelevizioneve (URTI). Më pas u emërua menaxher për strategji zhvillimore në Radiotelevizionin e Kosovës. Ka bërë specializime jashtë vendit dhe trajnime të ndryshme. (Rrahman Paçarizi)

HASANI Besim (1957-). Punëtor sportiv. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, shkollën e mesme dhe Fakultetin Ekonomik i kreu në Prishtinë. Nga viti 1992 deri në vitin 1999 ishte nënkryetar dhe sekretar i Federatës së Karatesë së Kosovës, ndërsa nga viti 2011 është edhe kryetar i Federatës së Karlingut të Kosovës. Është marrë me karate. Në krye të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) u zgjodh në vitin 1996 dhe këtë detyrë e ushtroi edhe kur Kosova u pranua në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar në fund të vitit 2014. Ai, së bashku me delegacionin dhe sportistët kosovarë, për herë të parë u paraqitën në një ngjarje shumësportëshe në Lojërat Europiane “Baku 2015”. (Tahir Sopi)

HASANI Enver (1962-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet e drejtësisë i përfundoi në vitin 1984 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku kreu edhe ato pasuniversitare.



ENVER HASANI

Magjistraturën e dytë e mbaroi në Universitetin “Bilkent” të Ankarasë, në drejtimin ndërkombëtar, ku edhe doktoroi në vitin 2001. Është profesor i rregullt në Fakultetin Juridik të UP-së për lëndët e drejta ndërkombëtare publike dhe e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Një kohë ishte këshilltar ligjor në Ministrinë e Jashtme të Republikës së Shqipërisë (1992-1997), pastaj drejtor i Qendrës për të Drejtat e Njeriut të UP-së (2000-2002), një vit dekan i Fakultetit Juridik (2005-2006) dhe rektor i UP-së në periudhën 2006-2009. Në vitin 2009 u zgjodh kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ku qëndroi deri në fund të mandatit (2015). Është autor punimesh shkencore dhe profesionale, të botuara brenda dhe jashtë vendit. Në studimet e tij trajtoi parimin e të drejtës për vetëvendosje gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, si një e drejtë që u takonte vetëm ish-republikave jugosllave. Këtë tezë e kishte trajtuar në disa nga librat e tij në gjuhën angleze, si: “Shpërbërja e Jugosllavisë dhe rasti i Kosovës, aspekte politike dhe juridike” (1999) dhe “Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm, rasti i Jugosllavisë” (1913) etj. (Osman Ismaili).

HASANI Fejzullah (1960-). Jurist, mësimdhënës universiteti. Lindi në fshatin Hodonoc, komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Breznicë e Epërme, (komuna e Bujanocit), ndërsa gjimnazin në Gjilan. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe studimet e doktoratës. Filloi me punë në organizatën punuese “Kosovka” në Kamenicë, si sekretar i ndërmarrjes. Në vitin 1988 u emërua gjyqtar i Gjykatës Komunale po në



FEJZULLAH HASANI

Kamenicë, ku punoi deri në vitin 1992, kur përjashtohet nga puna nga pushteti serb. Gjatë viteve 1992-1999 punoi avokat i licencuar. Në vitin 1999 u emërua kryetar i Gjykatës Komunale në Kamenicë, ndërkaq në vitin 2003 u emërua gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës. Nga viti 2010 është kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës. Është profesor për lëndën e drejta penale në Fakultetin Juridik të Universitetit publik “Kadri Zeka” në Gjiilan. Është anëtar i Bordit të Institutit për Demokraci Kulturore me seli në Berlin. Ka botuar punime nga fusha e të drejtës penale. (Osman Ismaili).

HASANI Hasan (1947-). Shkrimtar. Lindi në Jabllanicë të Gjakovës. Kreu shkollimin në vendlindje dhe në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e




HASAN HASANI

Prishtinës. Me krijimtari letrare dhe publicistike merret nga viti 1965, kur e botoi poezinë e parë në revistën letrare “Jeta e re”. Punoi si gazetar dhe redaktor në gazetën arsimore “Shkëndija”, në revistën për art dhe letërsi “Fjala” dhe në revistën letrare “Jeta e re”. Gjithashtu ishte kryeredaktor i revistës letrare për fëmijë “Pionieri”. Ka botuar vepra me poezi për fëmijë, poezi për të rritur, prozë, kritikë letrare, vepra publicistike e leksikografike etj. Veprat me poezi: “Më bekoj pa gjuhë” (1971), “Muza shqiptare” (1997); pastaj romanet: “Ulërima” (1989), “Kohë të egra” (2006), “Kodi i jakut” (2014). Është autor i botimeve “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-2001” (2003), “Leksikoni i nobelistëve të letërsisë” (2011) etj. Në veprat e tij letrare H. Hasani trajton tema sociale, të dashurisë, të rezistencës kombëtare etj. Është kryeredaktor i revistës letrare për fëmijë “Pionieri”. (Sali Bashota)

HASANI Isak (1943-). Gazetar. Lindi në Podujevë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1965 nis bashkëpunimin me gazetën “Rilindja”, si korrespondent nga Podujeva, pastaj kaloi në redaksi në Prishtinë, ku punoi deri në pensionim si gazetar, reporter i lirë, komentator politik, redaktor i

rubrikës së politikës së brendshme, ndihmës i kryeredaktorit dhe zëvendëskryeredaktor. Pas ndaljes së “Rilindjes” më 1990 vazhdon punën e gazetarit dhe të redaktorit në gazetën “Bujku”. Pas luftës ishte redaktor i politikës së jashtme në “Rilindje” deri në vitin 2002, kur përfundimisht pushoi të dalë kjo gazetë. (Zenun Çelaj)

HASANI Ismail (1953-). Sociolog, profesor universitar. Lindi në Devetak të Ferizajit. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në Ferizaj, studimet në Universitetin e Prishtinës (UP), në katedrën



ISMAIL HASANI

filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik. Mbaroi studimet e magjistraturës po për sociologji në Universitetin e Zagrebit, ndërsa u doktoroi në Universitetin e Shkupit (1996). Në procesin arsimor u angazhua që nga viti 1978. Punoi si mësimpldhënës dhe drejtor i Shkollës së Lartë Teknike në Ferizaj deri më 1999. U angazhua si mësimpldhënës në departamentin e sociologjisë në Fakultetin Filozofik të UP-së në periudhën 2000-2010, pastaj në Universitetin e Stavanger-it, Norvegji, dhe si bashkëpunëtor i jashtëm në Institutin për Studimin e Raporteve Ndëretnike në Universitetin “Leiden” në Holandë. Ka botuar disa libra kryesisht nga fusha e sociologjisë së religjionit: “Probleme teorike nga sociologjia e religjionit” (1996), “Vetëdija fetare dhe kombëtare te shqiptarët” (2001), “Shekullarizimi dhe shoqëria bashkëkohore” (1997) etj. Ka publikuar edhe një numër artikujsh shkencorë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. (Gëzim Selaci)

HASANI Nait (1965-). Veprimtar, i burgosur politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Randobravë të Prizrenit. Veprimtarinë politike e filloi që në shkollë të mesme. Për herë të parë u arrestua dhe u dënua në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit (1984) më 3 vjet e gjysmë burg. Herën e dytë u arrestua më 27 shtator 1988 dhe u dënua nga e njëjta Gjykatë me 6 vjet burg, për t’u liruar pas 19 muajsh, më 1990, duke përfituar nga amnistia për të gjithë të burgosurit politikë. Në nëntor të vitit 1994 ishte njëri nga nënshkruesit



NAIT HASANI

për themelimin e UÇK-së dhe u caktua koordinatori kryesor i UÇK-së për Kosovë. Herën e fundit u arrestua më 28 janar 1997, kur u kidnapua nga policia sekrete serbe. Pas torturave brutale, në gjendje kome, me lëndime të

rënda trupore u dërgua në Spitalin e Prishtinës. Në gjendje të pavetëdijshme u nxor nga spitali dhe pas një muaji u mor vesh se ishte mbajtur në bazën e sigurimit serb në Ajvali. Gjykata serbe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Edhe gjatë mbajtjes së burgut u torturua vazhdimisht nga autoritetet e burgut. U plagos në masakrën e Burgut të Dubravës. Pas luftës dhe daljes nga burgu, N. Hasani u angazhua në radhët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe u zgjodh deputet i Parlamentit të Kosovës në tri legjislatura radhazi. (Ruzhdi Jashari)

HASANI Qemajl (1946-). Politikan, inxhinier. Lindi në Oshlan të Vushtrrisë. Shkollën fillore dhe atë të mesme teknike i kreu në Mitrovicë, kurse në vitin 1979 diplomoi inxhinierinë kibernetike në Universitetin e Beogradit, ku kreu edhe studimet pasuniversitare. Prej vitit 1964-1967 punoi si teknik i makinerisë në kombinatin “Elektroekonomia e Kosovës”, ndërsa në vitet 1967-1974 ishte kryetar i Rinisë së Prishtinës. Në periudhën 1974-1978 ka ushtruar funksionin e redaktorit përgjegjës të programit informativ të Radiotelevizionit të Prishtinës, ndërsa në vitet 1978-1982 ishte sekretar ekzekutiv i Komitetit Komunal të Lidhjes Komuniste të Prishtinës dhe më pas sekretar ekzekutiv i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës. Ishte drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit të Prishtinës (1986-1989) dhe drejtor i Pallatit të Rinisë në Prishtinë, post nga i cili u shkarkua me vendim të Kuvendit të Serbisë (1990). Pas çlirimit të Kosovës, në periudhën 2001-2006 u rikthye në detyrën e drejtorit të Pallatit të Rinisë në Prishtinë, kurse në vitet 2011-2014 ishte këshilltar politik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. (Nerxhivane G. Dauti)

HASANI Rexhep (1954-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Strellc,

komuna e Kërçovës. Shkollimin e kreu në vendlindje dhe në Prishtinë, ndërsa studimet e elektronikës dhe të telekomunikacionit i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës (UP) (1978). Pas diplomimit punoi inxhinier përgjegjës për lidhje në Televizionin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1987). Mbrojti disertacionin më 2006 në lëmin e elektroteknikës në Fakultetin Elektroteknik të UP-së. Ndërkohë u zgjodh asistent dhe më pas ligjërues dhe profesor i asociuar për lëndët: sistemet transmetuese, teoria e informacionit, teoria dhe teknikat e kodimit dhe përpunimi digjital i imazhit. Gjatë punës në fakultet, si autor dhe bashkautor, publikoi disa punime shkencore dhe profesionale në revista të vendit dhe ato ndërkombëtare. Ishte i angazhuar për revidimin e projekteve nga lëmi i telekomunikacionit. Në periudhën 1998-2001 ushtroi funksionin e zëvendësministrit në Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve të Maqedonisë. Aktualisht është mësimdhënës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë. (Enver Hamiti).

HASANI Rexhep (1961-). Gazetar i sportit, mësimdhënës. Lindi në Norçë të Preshevës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë. Që nga viti 1985 ushtroi profesionin e gazetarit të sportit, fillimisht në Televizionin e Prishtinës dhe, pas mbylljes së tij, në “Top sporti”, në “Bujku” dhe “Rilindja”. Nga viti 2001 deri më 2011 ka qenë gazetar në të përditshmen “Zëri”, ndërsa në të përditshmen sportive “Topi” kreu punën e gazetarit dhe të redaktorit. Është autor i librit “Qëndresa dhe krenaria e basketbollit”. Ka marrë disa mirënjohje për punë të suksesshme në gazetarinë e sportit. (Ejup Llumnica)

HASANI Sinan (1922-2010). Politikan, shkrimtar. Lindi në Pozharan të Vitisë. Në vendlindje kreu shkollën fillore, pastaj ndoqi Medresenë e Madhe në Shkup, kur u përfshi në lëvizjen komuniste dhe në aradhet partizane. Më 1944 u zu rob dhe fundin e luftës e priti në kampin nazist në Vjenë. Që nga paslufta, deri në vitin 1989 ishte në detyra e funksione të ndryshme politike në Gjilan, në Prishtinë dhe në Beograd. Pas luftës së Dytë Botërore ishte

sekretar rrethi i Partisë Komuniste në Gjilan, drejtor i “Rilindjes”, kryetar i Lidhjes Socialiste të Kosovës, kryetar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe kryetar i Kryesisë së Jugosllavisë. Në vitet 1971-1974 ishte ambasador i Jugosllavisë në Danimarkë. Deri në vitin 1980 ishte njëri prej nënkryetarëve të Kuvendit Federativ. Pas demonstratave në Kosovë, në vitin 1981 u kthye në Prishtinë si kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës (1983-1984), kur u shqua veçmas me angazhimet e tij kundër të ashtuquajturit nacionalizëm dhe irredentizëm shqiptar. Në vitin 1984 u zgjodh anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë, ndërsa nga 15 maji 1986 deri më 15 maj 1987 ishte kryetar i Kryesisë së Jugosllavisë. Në fushën e letërsisë botoi disa romane (“Rrushka ka nis me u pjekë”, “Djaloshi me dekoratë”, “Era dhe lisi” etj.). Më 1990 u pensionua dhe jetoi deri në vdekje në Budvë të Malit të Zi. (Ali Cenaj)

HASBAHTI Hasan (1928-). Inxhinier, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, shkollën fillore e kreu në Pejë, të mesmen në Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Makinerisë në Universitetin e Beogradit (1955). Studimet e magjistraturës dhe të doktoratës në Universitetin e Nishit (1988). Punoi në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë, ndërsa në vitin 1957 kaloi me punë në kombinatin “Trepça”, ku punoi si udhëheqës i ekipit të mirëmbajtjes, më pas udhëheqës i departamentit projektues, pastaj drejtor i Fabrikës së Akumulatorëve (1963-1973) dhe zëvendësdrejtor gjeneral i kombinatit “Trepça” (1973-1986). Karrierën profesionale e përfundoi në Bankën e Kosovës “Bankkos”. Në periudhën 1975-1985 ishte ligjërues në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe në Shkollën e Lartë Teknike të Mitrovicës. Ishte drejtues i prodhimit dhe i investimeve në fabrikat e akumulatorëve dhe të baterive në Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan. (Fehmi Krasniqi)

HASI. Trevë etnogjeografike në pjesën jugperëndimore të Kosovës, në kufirin Kosovë-Shqipëri. Është rajon gjeografik me kufij të përcaktuar qartë, i rrethuar pothuajse në të gjitha anët me lumenj. Ndryshe njihet si zona rrëzë Pashtrikut. Përfshin sipërfaqe prej 690.7 km². Në vitin 1913 Hasi u nda në dy pjesë. Hasi i Kosovës përfshin një sipërfaqe prej 316.7 km², shtrihet nga fshati Gorozhup

i Prizrenit deri te fshati Devë i Gjakovës, në mes të lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku në njërin anë dhe malit të Pashtrikut, në anën tjetër. Hasi shquhet me natyrë të larmishme gjeologjike. Pjesa jugore përfaqëson një pllajë karstike të kretakut, me lartësi 800-1,000 m, të vendosur mbi shkëmbinj ultrabazikë, kurse në veri, nga Godeni deri te Deva është i ndërtuar nga shkëmbinj ultrabazikë, në pjesën fushore nga depozitimet e neogjenit. Relievi dominohet nga format karstike (hinka, gropa, lugje, shpella). Pikën më të lartë e përbën maja e Pashtrikut (1,988 m), kurse pjesën më të ulët e përbëjnë rrafshet aluviale të Drinit të Bardhë dhe të Erenikut. Ka lartësi mesatare mbidetare 612 m. Hasi është vend i thatë, me mungesë të theksuar të ujit. Sasia e reshjeve është relativisht e lartë (900 mm), por uji i reshjeve atmosferike humbet me shpejtësi në brendi të gëlqerorëve. Etjen e shuajnë burimet karstike (gurra e Kusarit, Damjanit, Kushninit, Kabashit etj.). Lumi kryesor është Destica (9.5 km). Hasi është i pasur me lloje bimore dhe shtazore, endemike dhe relikte. Peizazhin e dominojnë shkurret dhe livadhet. Toka e punës është e kufizuar, në rrafshet aluviale të Drinit të Bardhë dhe të Erenikut. Në këtë zonë jetojnë rreth 40,793 banorë (2011), të shpërndarë në 34 vendbanime: 19 vendbanime janë nën administrimin e komunës së Gjakovës, ndërsa 15 të tjera janë nën komunën e Prizrenit. Qendra kryesore për pjesën administrative të Prizrenit është Gjonaj, kurse për pjesën administrative të Gjakovës është Rogova. Dikur qendra kryesore ishte Zymi. Hasjanët janë të njohur me zejen e bukëpjekësit dhe veshjen e tyre karakteristike. (Selim Qevani)

HASI Besnik (1971-). Futbollist, trajner. Lindi në Gjakovë. Hapat e parë i mori te skuadra e “Vëllaznimit”. Pas dy vjetësh kaloi te Zagrebi dhe më pas luajti për “Dinamon” e Pançevës, për “Prishtinën” e “Samoborin”. Në vitin 1994 kaloi te skuadra belge “Genk”, ku qëndroi për gjashtë vite. Në edicionin 1997/98 u huazua te “Muenchen 1860”, më pas u kthye te “Genku”, që ta fitojë titullin e kampionit të Belgjikës (1998/99) dhe kupën (1999/2000). Prej “Genkut” kaloi tek “Anderlehti” (2000-2006). Me “Anderlehtin” fitoi tri herë titullin e kampionit të Belgjikës dhe një herë kupën, kurse mori pjesë edhe në garat e Ligës së Kampionëve. Pas “Anderlehtit”, karrierën e

vazhdoi te skuadra e “Lokeren-it” dhe “Cercle Brugge”, ku edhe e përfundoi karrierën si futbollist aktiv (2008). Për shtatë vjet luajti edhe për kombëtaren e Shqipërisë (2000-2007), në 47 paraqitje. Në vitin 2008 u emërua zëvendëstrajner i “Anderlechtit” dhe pas katër vjetësh mori detyrën e kryetrajnerit. Si trajner i “Anderlechtit” ka fituar një titull të kampionit dhe ishte pjesëmarrës i fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve në edicionin e parë. (Tahir Sopi)

HASI Pali prej (shek. XVI). Prift dhe autor tekstesh në varg para kohës së Budit, me gjasë i pjesës II të shek. XVI. Pali prej Hasi duket të jetë autor i dy vjershave të gjata të përfshira të “Doktrina e kërshenë” 1618, të përmendura nga vetë Budi, i cili thotë se i kishte marrë prej tij duke bërë disa shtesa apo ndryshime të vogla. Supozohet se të tilla janë vjershat e gjata “Dita e gjyqit” dhe “Mbi vdekjen”. (Rexhep Ismajli)

HASIMJA Skënder (1931-1980). Inxhinier, arkitekt-projektues, mësimdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën mesmen teknike e kreu në Prishtinë. Kreu studimet në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Beogradit (1960). Pas diplomimit punoi në disa ndërmarrje e in-stitucione. Ishte drejtor i përgjithshëm në kombinatat ndërtimore “Ramiz Sadiku” të Prishtinës dhe “Dukagjini” të Gjakovës. Ishte i përfshirë edhe në procesin mësimor në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, si ligjërues i lëndës gjeometria deskriptive. S.Hasimja ka një veprimtari të gjerë të projekteve origjinale të objekteve të ndërtuara në Kosovë dhe jashtë saj. Ishte fitues në konkursin për Parkun Përkujtimor të Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ) në Rahovec, për bashkësinë lokale “Bregu i Diellit” në Prishtinë, për rikonstruktimin e Fabrikës së Konfeksionit në Gjakovë, për Spitalin e Përgjithshëm po në Gjakovë, për Kompleksin Përkujtimor të LNÇ-së në Çabrat etj. (Fetah Jagxhiu).

HASIMJA Zija (1950-). Gazetar. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Filloi të merret me gazetari që nga ditët studentore në Prishtinë, nga viti 1967. Pas kryerjes së studimeve në Fakultetin Filologjik në Prishtinë, u kthye në Gjakovë, si korrespondent i gazetës

“Rilindja” dhe i Radio Prishtinës. Në vitin 1972 kaloi me punë në redaksinë e “Rilindjes” në Prishtinë, ku për disa vjet punoi në sektorin e politikës së brendshme. Më pas u kthye sërish në Gjakovë, si korrespondent i “Rilindjes” dhe i gazetës “Bujku”, deri në mbylljen e tyre. Deri në pensionim (2003) ishte korrespondent nga Gjakova i disa medieëve. (Nehat Islami)

HASKUKA Esat (1936-2004). Gjeograf, mësimdhënës universiteti. Lindi në Prizren, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Shkollimin e lartë për gjeografi e mbaroi në Universitetin e Shkupit (1961), magjistroi dhe doktoroi në Universitetin e Zagrebit (1984) me analizën gjeografike të funksioneve urbane të Prizrenit. Deri në vitin 1976 punoi pedagog në shkolla të mesme në Prizren, më pas u zgjodh profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë. Në vitin 1993 u zgjodh ligjërues në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës. Botoi punime shkencore dhe disa botime të veçanta nga fusha profesionale, si: “Analiza historiko-gjeografike e funksioneve urbane të Prizrenit” (1985) dhe tekstet “Gjeografia fizike e përgjithshme 1” (1997) dhe “Gjeografia fizike e përgjithshme 2” (2001). U mor kryesisht me studime nga fusha e gjeografisë fizike, social-ekonomike dhe me strukturën rajonale-urbane të Prizrenit dhe pjesërisht të zonës jugore të Dukagjinit. (Nesim Vala)

HASHANI Bajram (1953-). Boksier. Lindi në Prishtinë. Me boks filloi të merret që në moshën rinore, në klubin e boksit “Prishtina”. Kulmin e suksesit e arriti në vitin 1974, kur fitoi shumë turne të ish-Jugosllavisë. Një vit më vonë fitoi titullin e kampionit të ish-Jugosllavisë. Po këtë vit mori pjesë edhe në Kampionatin Europian të Boksit në Katovicë të Polonisë, ku fitoi medaljen e bronzit. Në vitet ‘80 emigroi në SHBA, ku vazhdoi karrierën në boks in amator. Në vitin 1984 fitoi “Dorëzën e Artë”, duke u bërë shqiptari i dytë që e fitoi këtë trofe (pas Elvir Muriqit). Në vitin 1989 nis studimet për trajner, që i përfundoi me sukses. Jeton në SHBA dhe merret me menaxhimin e boksit dhe kik-boksit. (Lulzim Shala)

HASHANI Habib (1939-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Obiliq, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen në Prishtinë dhe në

Mitrovicë. Fakultetin Juridik e kreu në Beograd, ku magjistroi dhe doktoroi. Një kohë punoi në Kuvendin Komunal në Obiliq, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku ishte edhe kryetar i saj, si dhe gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës. Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP) u zgjodh asistent e më pas profesor për lëndën e drejta ndërkombëtare private dhe e drejta ndërkombëtare ekonomike. Ka ushtruar funksione të ndryshme partiake dhe politike në periudhën e autonomisë së Kosovës. Është autor i një numri punimesh shkencore nga fusha e së drejtës ndërkombëtare private. Pas vendosjes së masave të dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga Serbia në vitin 1991 vazhdoi të mbante mësim në gjuhën serbe, po në Fakultetin Juridik. (Ismet Salihu)

HASHANI Ismet (1957-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Obiliq, shkollimin bazë e mori në vendlindje, studimet për kimi i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1980. Disa vjet punoi mësimdhënës në shkollat e mesme në Lipjan dhe në Prishtinë (1980-1984). Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1987), ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1990). Në vitin 1984 u zgjodh asistentit në FSHMN dhe po në këtë fakultet mori të gjithë titujt universitarë. Kreu detyra në institucionet e arsimit të lartë dhe ishte bartës i funksioneve shtetërore dhe politike: kryetar i komunës së Obiliqit (2002-2007), zv/ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës (2008-2010) etj. Ka publikuar punime në disa revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare, ka mbajtur kumtesa në tubime shkencore me karakter rajonal e ndërkombëtar dhe është autor i teksteve shkollore dhe bartës i projekteve të ndryshme. (Salih Gashi)

HASHANI Sabri (1949-). Punëtor sportiv. Lindi në Obiliq, ku kreu shkollën fillore, ndërkaq të mesmen në Prishtinë. Kreu studimet universitare në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Që në moshë të re filloi të merret me pingpong. Ishte 10 herë kampion i Kosovë në çifte dhe një herë kampion vetjak në vitin 1969. Luajti edhe futboll për skuadrat: “Besëlidhja” dhe KXEK “Kosova”. Në vitin 2000 u emërua kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe qëndroi deri në fillim të vitit 2008. Ishte anëtar

i kryesisë së Federatës së Sporteve të Pavarura të Kosovës, si dhe anëtar i kryesisë së Lidhjes së Sporteve të Universitetit të Prishtinës. Ishte delegat i Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe i shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut në vitin 1990. (Florim Maliqaj)

HASHANI Shaban (1945-2010). Historian, veprimtar. Lindi në Ferizaj. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje. Studioi për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas vazhdoi studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit (1986). Në fillim punoi arsimtar i historisë në disa fshatra të Ferizajt. Në vitin 1980-1981 punoi hulumtues i pavarur shkencor në Institutin e Historisë në Prishtinë. Më pas ishte drejtor i Qendrës së Arsimit të Orientuar dhe sekretar i Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për Arsim dhe Edukim në Ferizaj. Në vitin 1990 një kohë të shkurtër ishte drejtor i Arkivit të Kosovës. Ishte delegat i Kuvendit të Kosovës, në përbërjen e cila shpalli Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 dhe miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 7 shtator në Kaçanik. Për shkak se ndiqej nga pushteti serb, disa vjet i kaloi në mërgim. Është autor i monografive: “Ferizaji dhe rrethina e tij në lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941-1945” (1879), “Ferizaji dhe rrethina e tij prej vitit 1873-1941” (1985) dhe i një sërë punimesh kryesisht për qytetin e Ferizajt, të botuara në revista të ndryshme shkencore. (Alban Dobruna)

HASHIMI Shaban (1924-2001). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Shqipëri, kurse gjimnazin në Prishtinë (1944). Kreu



SHABAN HASHIMI

studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Beogradit (1954). Ishte inxhinieri i parë në lëmin e elektroteknikës në Kosovë. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1974), ndërsa disertacionin e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (UP) (1983). Si pjesëmarrës në LNÇ, në vitin 1944 burgoset dhe internohet në Vjenë. Në Prishtinë punoi si mësues e pastaj si mësimd-

hënës në gjimnaz për lëndët matematikë, fizikë dhe kimi. Pas studimeve punësohet në kombinatin “Trepça”, në minierën e Stantërgut, pastaj në termocentralet “Kosova” në Obiliq dhe më vonë në ndërmarrjen “Energoinvest” në Prishtinë. Më 1963 u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Prishtinë për lëndën matjet elektrike. Po në atë kohë ishte për specializim në Londër, ndërsa më 1969 u zgjodh ligjërues në Fakultetin Elektroteknik, ku merr edhe titullin e profesorit ordinar (1978) për lëndët matje elektrike, ndriçimet dhe instalimet elektrike. Kreu dhe detyrën e drejtorit të Shkollës së Lartë Teknike dhe të dekanit të Fakultetit Teknik të UP-së. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve shkencore të publikuar në revista ndërkombëtare. (Ali Gashi)

HATIPI Burim (1946-1995). Gazetar i sportit, futbollist, trajner. Lindi në Prizren. Nga viti 1963 deri më 1977 luajti për KF “Prishtina”, kryesisht në Ligën e dytë të ish-Jugosllavisë. Luajti disa ndeshje edhe për skuadrën e të rinjve të Jugosllavisë. Me të përfunduar karrierën e futbollistit aktiv, nis të punojë si gazetar i sportit në të përditshmen “Rilindja”, më pas redaktor në gazetën “Bujku”. Pati angazhime edhe në revistat sportive “Reflekse sportive” dhe “Top sport” etj. Në fund të viteve ‘80 punoi edhe si delegat futbolla në ligën e parë dhe të dytë të ish-Jugosllavisë. Një stinor (1994/95) ishte kryetrajner i KF “Prishtina”, me çrast arriti ta drejtojë klubin deri në trofeu i Kupës së Kosovës. (Moral Pozhegu)

HATIPI Myzafere (1917-2007). Mësuese veterane. Lindinë Dardaneletë Turqisë. Arsimin fillor e mori në Shkodër, Durrës dhe Elbasan, ndërsa arsimin e mesëm në Institutin Femnor “Naim Frashëri” (dega e normales) në Tiranë. Më 1938 u punësua si mësuese në Tepelenë, pastaj në Shkodër dhe në Tiranë, ndërsa në vitin 1942 u angazhua mësimdhënëse e gjuhës shqipe në gjimnazin e ulët të Prizrenit, pastaj mësuese në Korishë të Prizrenit. Për shkak të pjesëmarrjes në demonstratat antifashiste, arrestohet dhe internohet në Austri. Pas Luftës së Dytë Botërore, inkuadrohet mësimdhënëse në Normalen e Gjakovës, mësuese e ushtrimore e Normales së Prishtinës. (Fahri Buçinca)

ushtrimore e Normales së Prishtinës. (Fahri Buçinca)

HATIPI Tajar (1918-1978). Shkrimtar, gazetar, përkthyes. Lindi në Elbasan, ku kreu shkollën fillore dhe Normalen. U emërua mësues në fshatin Duhël, ku punoi disa vjet. Pas Luftës së Dytë Botërore dha mësim në gjimnazin e Prizrenit dhe punoi si inspektor dhe drejtor shkolle në këtë qytet. Më 1947 u transferua mësimdhënëse në Normalen e Gjakovës, pastaj në Normalen e Prishtinës. Pas vitit 1962 punoi si redaktor dhe kryeredaktor i revistës “Pionieri” dhe anëtar i redaksisë së revistave “Jeta e re”, “Përparmi”, “Gazeta e pionierëve” dhe kryeredaktor i “Thumbit”. Shkroi kryesisht prozë për fëmijë dhe për të rritur. Ishte ndër humoristët e paktë të kohës së vet. Tregimet e tij qoftë për fëmijë, qoftë për të rritur, pëlqeheshin për humorin e lehtë që i përshkonte. Përmbledhja e tregimeve humoristike “Buni” që ndër librat e parë të këtij zhanri në Kosovë dhe Buni u bë personazh i dashur për lexuesit e atëhershëm. Nëpërmjet situatave të përditshmërisë thumboi dukuritë negative dhe veset e njerëzve të kohës. U mor edhe me përkthime letrare. Dha ndihmesë të çmuar për redaktimin gjuhësor të shkrimeve të bashkëpunëtorëve të revistave ku punonte. Veprat e botuara: “Rrethimi” (1962), “Buni” (1963), “Gjurmë kohe” (1968, “U bëra trim” (1973) dhe “Vrima thesi” (1977). (Arif Demolli)

HAXHAJ Ardian (1976-). Shkrimtar. Lindi në Gllarevë të Klinës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, gjimnazin në Klinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ka botuar përmbledhjen me poezi “Vdekja ulërin në sytë e mi” (1994) dhe romanet: “Fund i një misioni” (2006), “Kryekronika e Fushës së Kosovës” (2008), “Kujtimet e një çifuti” 2010 ; “Dështimi i madh” (2013). Është fitues i disa çmimeve letrare: për romanin më të mirë të vitit 2010 nga Ministria e Kulturës, pastaj çmimin e dytë në konkursin letrar të Shtëpisë Botuese “Buzuku” (2006). A. Haxhaj shkruan edhe skenarë për filma artistikë të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër, si dhe skenarë për seriale televizive, pastaj studime dhe ese për çështje të ndryshme të letërsisë dhe kulturës. (Adil Olluri)

HAXHIA Emir (1968-). Mjek, kirurg, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Studimet për mjekësi i filloi në Prishtinë, i vazhdoi në Sarajevë dhe i përfundoi në Grac të Austrisë (1998). Ishte bashkëpunëtor shkencor në repartin e neonatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Grac (1993-1998). Mori çmimin “Otto-Thalhammer-Preis” të Shoqatës Austriake për Perinatologji (1995). Mbrojti tezën e disertacionit më 1998 dhe u shpërblye me çmimin “Joseph-Krainer-Preis” nga qeveria e Steiermarkut. Specializimin për kirurgji të fëmijëve e filloi më 1999 dhe u trajnuar në Miçigen, SHBA. Më pas mori edhe titullin specialist i mjekësisë intensive për fëmijë (2008). Në vitin 2009 mori certifikimin europian për kirurgjinë e fëmijëve dhe po atë vit përfundoi habilitacionin në Fakultetin e Mjekësisë në Grac dhe u zgjodh profesor i asociuar në këtë fakultet. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe i disa kapitujve në libra profesionale për kirurgji dhe traumatologji të fëmijëve. Është anëtar i bordit shkencor të Shoqatës Europiane të Kirurgëve për Fëmijë (EUPSA) dhe anëtar themelues i Shoqatës Europiane të Kirurgëve Endoskopikë për Fëmijë (ESPES). (Isuf Dedushaj)

HAXHIA Zhukë (1885-1965). Luftëtar për çlirim kombëtar në Kosovë, veprimtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Lindi në Stakaj të Rugovës. I ati i tij, Haxhi Çela, ishte komandant, kurse gjyshi i tij, Çelë Shabani, ishte veprimtar i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në mbrojtjen e kufirit shqiptar nga Mali i Zi. Më 1911 mori pjesë në Luftën e Beranit. Më 1912 merr pjesë në luftën e Moknës. Gjatë viteve 1918-1924 ishte ndër luftëtarët e dalluar të Rugovës. Në vitet 1930-1935 ishte kryetar i komunës së Rugovës, ndërsa në periudhën 1941-1945 u bë komandant i njësiteve vullnetare të Rugovës. Me vullnetarët e tij ruante vijën kufitare me Malin e Zi. Në Kuvendin e Dobërdolit të LNDSH-së u zgjodh udhëheqës për Rugovën. Pas rivendosjes së pushtetit jugosllav, vazhdoi qëndresën deri më 1947 kur u dorëzua. U dënua me vdekje. Dënimi më vonë iu shndërrua në burgim të përjetshëm e pastaj në 20 vjet. Lirohet në vitin 1960. Vdiq në Lutogllavë të Pejës. (Lush Culaj).

HAXHIAJ Blerim (1976-). Gazetar. Lindi në Tropojë, Shqipëri. Shkollimin e kreu në

vendlindje, në Tiranë dhe më pas në Prishtinë. Studioi për gazetari në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës dhe në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Punën e gazetarit e nisi në Radio-Tiranë dhe më pas në gazetën e përjavshme “Tribuna shqiptare” dhe në gazetën “Dita”. Në vitin 2000 filloi punën si gazetar në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), në vitin 2002 u bë redaktor përgjegjës i lajmeve “Blic”, producent ekzekutiv dhe prezantues i programit “Mirëmëngjesi Kosovë” në RTK. Shkruan gjithashtu editoriale dhe në gazetën e përditshme “Kosova sot”. Është autor i dramës “Mendje djallëzore”, e cila është vënë në skenë në Teatrin “Istref Begolli” në Pejë (2015). (Artan Krasniqi)

HAXHIBEQIRI Qamil (1949-). Matematikan, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Gjakovë, ku



QAMIL
HAXHIBEQIRI

kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studimet për matematikë i përfundoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1971, studimet pasuniversitare dhe tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981). Më 1974 zgjidhet në FSHM të UP-së, ndërsa gradën e profesorit ordinar e arrin më 1994. Ligjëron edhe në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Gjakovës dhe në Universitetin e Prizrenit. Interesimi shkencor i Q. Haxhibeqirit është lëmi i topologjisë algjeb-riike. Botoi një numër punimesh shkencore në revista ndërkombëtare dhe vendore. Rezultatet e tij të dualitetit citohen në “Enciklopedinë e Matematikës” të Shoqatës së Matematikanëve të Europës. Publikoi disa tekste universitare, ndër të cilët “Topologjia” (1989) dhe “Hapësirat metrike” (2014) dhe disa tekste shkollore. Mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore ndërkombëtare. Për qëllime studimore qëndroi në disa universitete të Europës. Është kryetar i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës dhe anëtar i Shoqatës së Matematikanëve të Europës. Është zgjedhur anëtar korrespondent i ASHAK-ut më 2012. (Minir Efendija)

HAXHIBEQIRI Sami (1933-1998). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe kirurg torakal, mësimsdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në Mitrovicë, të mesmen në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Shkupit (1959), ndërsa specializimin për kirurgji të përgjithshme e kreu në Beograd. Ishte kirurgu i parë shqiptar në ish-Jugosllavi. Gjatë periudhës 1966-1968



SAMI
HAXHIBEQIRI

ishte shëf i shërbimit kirurgjik në spitalin e Mitrovicës. Më 1972 kreu specializimin për kirurgji torakale në Akademinë Ushtarake në Beograd. Në vitin 1971 u emërua ligjërues i parë i lëndës së kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më 1981 kaloi me punë në repartin e kirurgjisë torakale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Më 1990 u përjashtua nga puna bashkë me kolegët e tjerë. Gjatë viteve në vijim dha një kontribut të çmuar në trajtimin mjekësor dhe kirurgjik të të plagosurve dhe popullatës civile në zonat e Drenicës dhe të Shalës së Bajgorës. Ishte koordinatori kryesor i të gjitha aktiviteteve në ambulancën e Shoqatës “Nënë Tereza” në Mitrovicë. Gjithashtu ka dhënë kontribut të madh në edukimin e kirurgëve të rinj dhe në zhvillimin e kirurgjisë në Kosovë. Ishte pjesëmarrës dhe bashkorganizator i shumë kongreseve të kirurgëve në ish-Jugosllavi dhe autor i shumë punimeve profesionale-shkencore. (Avdyll Krasniqi)

HAXHIHASANI Sejfulla (1915-1991). Mjek, pneumoftizilog. Lindi në Pirok të Tetovës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, Medresenë e Madhe në Shkup. U regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1936, ndërsa u diplomua më 1942 në Universitetin e Zagrebit. Pas diplomimit, si mjeku i parë shqiptar nga rajoni i Pollogut punoi në spitalin e Tetovës. Specializimin nga lëmi i pulmoftizilogjisë e përfundoi në Beograd (1958). Pas specializimit, deri në pensionim, punoi në Dispanserinë e Pulmoftizilogjisë në Tetovë. (Remzi Izairi)

HAXHIU Baton (1965-). Gazetar. Lindi në fshatin Poglek të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, studimet



BATON HAXHIU

në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1988-1991 punoi në të përjavshmen studentore “Bota e re”, një vit më pas redaktor në të përjavshmen “Epo-ka”. Në periudhën 1991-1993 ishte gazetar në të përjavshmen “Zëri” dhe më pas, deri në vitin 1997, gazetar dhe kolumnist në të përjavshmen “Koha”. Më 1997-1998 redaktor, ndërsa nga viti 1999-2002 kryeredaktor i të përditshmes “Koha ditore”. Është bashkëthemelues i “Gazetës Express”, të cilën e drejtoi në vitet 2006-2008. Në vitin 2008 themeloi dhe u bë drejtor i përgjithshëm i Televizionit “Klan Kosova”. Ndërkohë, përgjatë viteve 1990-2000 punoi analist në Institutin për Luftë dhe Paqe (IWPR), gazetar dhe analist në Radion “Deutsche Welle” dhe për një sërë mediesh dhe agjencish të njohura ndërkombëtare. Është opinionist i rregullt në emisionin “Opinion” të TV “Klan” të Shqipërisë. Ishte ndër themeluesit dhe drejtues i Asociacionit të Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës. Punoi në disa projekte hulumtuese, si në “Ballkan Observer”, “Currier International” etj. Është autor i librave “Kosova dhe ruleti ballkanik”, “Lufta ndryshe” etj. Në TV “Klan Kosova” mban emisionet e debatit. (Artan Krasniqi)

HAXHIU Bekim (1970-). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Ternac, komuna e Skënderajt. Kreu studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Kontaktet e para me UÇK-në i vendosi në pranverën e vitit 1997. Mori pjesë në organizimin e demonstratave të studentëve me 1 tetor 1997 dhe mbante koordinimin në mes të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe udhëheqjes së Unionit të Studentëve. Mori pjesë në disa aksione kundër forcave policore serbe, si aksioni në stacionin policor në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë. Ishte ndër ideatorët e themelimit të Radios “Kosova e lirë” në malet e Berishës. Ishte pjesë e luftës në disa zona, si në Dukagjin, Llap, Shalë dhe në Zonën e Drenicës. Nga Shtabi i Përgjithshëm u emërua komandant kompanie i Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”. Njihej me nofkën e luftës komandant “Kamishi”. Pas përfundimit të

luftës punoi në Shërbimin Informativ të Kosovës, më pas në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në vitin 2010 dhe 2014 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. (Haxhi Ademi)

HAXHIU Iljaz (1937-). Agronom. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, ndërsa Fakultetin e Bujqësisë, dega e lavërtarisë, e kreu në Universitetin e Sarajevës (1962). Punoi arsimtar në gjimnazin e Mitrovicës dhe agronom në kooperativën bujqësore në Vushtrri. Emërohet drejtor i kooperativës bujqësore në Prishtinë, më pas caktohet me detyrë në cilësinë e drejtorit të Kombinativit Bujqësor në Fushë-Kosovë (1969). Më vonë emërohet sekretar Krahinor për Bujqësi, Pyltari dhe Ekonomi të Ujërave. Më 1978 emërohet drejtor i përgjithshëm i Kombinativit të integruar agroindustrial të Kosovës “Kosova Export” në Prishtinë. Ka merita të veçanta për avancimin e bujqësisë në Kosovë dhe për ndërtimin e institucioneve në këtë fushë. (Agim Zajmi)

HAXHIU Isa (1941-). Inxhinier i elektroteknikës, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet për inxhinieri elektrike i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Beogradit (1964). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit. Pas studimeve punoi në Radiotelevizionin e Prishtinës, ndërsa më vonë angazhohet si mësimdhënës në qendrën shkollore teknike “19 Nëntori” dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë si mësimdhënës i lëndës elektroteknika me elektronikë. Gjatë vitit 1974 qëndroi në Britani të Madhe për specializim në fushën e transmetimit televiziv, po në Britani vijoi specializimin për filtra aktivë me amplifikatorë operacionalë. Ndërkohë u zgjodh mësimdhënës në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës për lëndët e elektronikës, teknikat e telekomunikacionit etj. Për disa vjet ishte i angazhuar edhe në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në degën e fizikës, si mësimdhënës i lëndës së elektronikës. (Enver Hamiti)

HAXHIU Muhedin (1949-). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në fshatin Peran të Podujevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Podujevë, kurse studimet në Fakultetin e Xehetarisë

të Universitetit të Sarajevës (1973). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Xehetarisë, të Gjeologjisë dhe të Naftës të Universitetit të Zagrebit. Pas diplomimit punësohet si inxhinier në minierën e linjtit në Bardh, ku kreu detyra të ndryshme në sistemin e prodhimit të qymyrit. Në vitin 1983 u zgjodh drejtor teknik i minierës sipërfaqësore të Bardhit, kurse në vitet 1987-1990 ishte drejtor i përgjithshëm i kësaj miniere. Pas largimit me dhunë nga puna, në periudhën 1990-1999 jetoi dhe punoi në Sllovaki. Pas kthimit në Kosovë, në vitet 1999-2002 ishte drejtor i minierës së Bardhit, kurse nga viti 2002-2007 ushtroi funksione të ndryshme në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës. Në periudhën 2012-2014 ishte drejtor i Institutit “Inkos”. Mori pjesë me kumtesa në disa simpoziume brenda dhe jashtë vendit nga lëmi i xehetarisë. (Shyqeri Kelmendi)

HAXHIU Musa (1939-2007). Mjek, fispatolog, pulmolog, kardiolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Pejë, shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1963). Punoi si pneumolog në Spitalin e Sëmundjeve të Mushkërive në Pejë (1968-1971). Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë, kaloi me punë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare për kardiologji i përfundoi në Universitetin e Beogradit dhe temën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit (1973). Vazhdoi specializimin dhe studimet plotësoese në Shkollën Mjekësore Pasuniversitare në Londër. Në Prishtinë kreu detyrën e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë (1973-1975). Është themelues i Institutit të Fiziologjisë Patologjike në këtë fakultet. Gjatë viteve 1975-1976 qëndroi në Universitetin e Pensilvanisë, në Filadelfia, SHBA. Në vitin 1978 ftohet në një qendër tjetër shkencore, në “Silikose Forschungsinstitut” të Bohumit në Gjermani. Në vitin 1979 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Për një mandat njëvjeçar (1978/79) ishte kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Fiziologëve të Jugosllavisë. Në vitin 1980 sërish qëndroi në “Silikose Forschungsinstitut” të Bohumit të Gjermanisë, si profesor i ftuar. Në vitin 1982 u



MUSA HAXHIU

ftua si profesor në “Case Western University” të Klivlendit në Ohaio, SHBA. Në vitin 1983 mori titullin profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa më 1990-1992 ishte kryetar i ASHAK-ut.

Ndonëse nga viti 1990 jetoi dhe veproi në Ohaio të SHBA-së, dha përkrahje të çmuar për studiuesit e rinj nga Kosova. Në “Case Western University” mbajti pozitën e profesorit në katër institute. Ishte i angazhuar në “Howard University” në Uashington, ku i vuri themelet e një laboratorit të neurofiziologjisë moderne. Ishte anëtar këshillit recensues i tri revistave më me zë të Shoqatës Amerikane të Fiziologjisë dhe të Neurofiziologjisë, ndërsa ishte anëtar i shumë shoqatave profesionale. Botoi disa monografi dhe tekste universitare dhe mbi 400 punime shkencore dhe kumtesa në revista më prestigjioze të kësaj fushe të studimeve. Vdiq dhe u varros në Ohaio, SHBA. (Isuf Dedushaj)

HAXHIU Qamil (1927-1988). Mjek, oftalmolog, profesor universiteti. Lindi në Rahovec, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Prizren. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1958). Një kohë punoi në Therandë si mjek i përgjithshëm. Më 1964 kaloi me punë në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë dhe më vonë në Klinikën e Syve në Prishtinë. Përfundoi specializimin në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup dhe më pas mbrojti temën e doktoratës nga fusha e oftalmologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së (1978). Është doktori i parë i shkencave në kësaj fushe në Kosovë. Ndërkohë, në vitin 1973 u zgjodh mësimdhënës dhe më pas edhe profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ishte drejtor i Klinikës së Oftalmologjisë me vite të tëra. Me emrin e tij lidhet ngushtë zhvillimi i oftalmologjisë në Kosovë. Mori pjesë në disa kongrese, konferenca dhe simpoziume shkencore, si dhe botoi një numër punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Ilhami Goranci)

HAXHIU-PULA Lejla (1959-). Pianiste. Lindi në Beograd. Nga viti 1960 jeton në Prishtinë. Shkollimin e mesëm muzikor (paralelisht me gjimnazin) e kreu në Prishtinë. Paraqitet e para i ka më 1973, kur përfaqësoi ish-Jugosllavinë në Krime (Ukrainë). Studioi Fakultetin e Arteve në Prishtinë, drejtimi i pianos. Në këtë kohë mori pjesë në Taki-met Ndërkombëtare të Studentëve në



LEJLA
HAXHIU-PULA

Novi-Sad, Beograd, Shkup, Dubrovnik, Zagreb, Rovinj, Opati. U prezantua në festivalet: “Skena Muzikore e Prishtinës”, “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Ditët e Muzikës” në Herceg Novi, “Ditët e Krijimtarisë Muzikore” në Opati. U diplomua më 1981, u shpall “Studente e dalluar” dhe me sukses e arsyetoi në festivalet: “Lojërat Verore të Dubrovnikut”, ku luajti Koncertin në G-dur për piano e orkestër të L. V. Beethovenit me Orkestrën e RTV Prishtinës. Kreu studimet e magjistraturës më 1986 në Beograd (prof. I. Lasko). Më 1981 u angazhua pedagoge e pianos në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Më 1996 studioi në Munihi. I kontribuoi ngritjes së kuadrove të profilit, përgatiti studentë për garat “N. Rubinshtajn” në Paris. Një kohë veproi në Grac. Aty dhe në Vjenë mbajti recitale (1999-2004). Luan me Filarmoninë e Shkupit dhe të Kosovës. U angazhua në muzikën kamerale: formoi Ansamblin “Ballkan sextet”, “Trio vivo”. Është kryetare e asociacionit kosovar “Shopen”, e festivalit “Shopen Piano-Fest”, anëtare e garave pianistike kombëtare dhe ndërkombëtare në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Ohër dhe Dubrovnik. (Sami Piraj)

HAXHIVASILEVIQ (Hadživasiljević) Jovan (1866-1948). Historian dhe etnograf serb. Lindi në Vranjë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Vranjë dhe në Nish, ndërsa studimet për histori i kreu në Beograd. Në vitin 1898 doktoroi në Vjenë, në shkencat filozofike. Punoi në diplomaci nga viti 1898 e deri me 1904. Ishte pjesëmarrës i luftërave ballkanike (1912-1913) dhe i Luftës së Parë Botërore (1914-1918). Ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në luftimet dhe masakrat e ushtrisë serbe gjatë pushtimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare. Është autor i veprave “Serbia e vjetër e jugut” (1909), “Aksioni çetnik në Serbinë e vjetër dhe Maqedoni” (1928) etj. Në veprat e tij mban qëndrim joobjektiv ndaj çështjes shqiptare. (Isa Bicaj)

HAXHOSAJ Halil (1946-). Shkrimtar. Lindi në Prekolluk (Preklukaj) të Vokshit afër Deçanit. Kreu Shkollën Normale dhe Shkollën e

Lartë Pedagogjike në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë e letërsi shqipe dhe studimet pasuniversitare në Prishtinë. Një kohë punoi si arsimtar në Cërmjan dhe mësimdhënës në gjimnazin e Gjakovës. Punoi si gazetar dhe redaktor në televizionet "Syri Vision" dhe "Opinion". Ka botuar librat me poezi: "Damarë të ringjallur" (1992), "Në kafaz me pantera" (1993), "Zëra të grisur" (1998), "Hija e orëligës" (2000), "Pastaj bëhu relik" (2003), "Fjalë e plagë" (2007), "Puhizë shpirti" (2010), "Puhizë zemre" (2009), "Lot e lakmi" (2012), pastaj librin me tregime "Pakohësi" (2005) dhe me kritikë letrare: "Përimtime letrare" (2006), "Proza romanore e Petrit Palushit" (2011), "Lexime të poezisë" (2013), përmbledhjen me vështrime teatrore "Kur ngrihet perdja", si dhe përmbledhjen me tregime "Shi pa vranësira" (2011), romanin "Histori në natën e vranët" (2008) etj. Në vitin 2004 botoi librin "Umbra viselor-Hija e ëndrrave", poezi shqip dhe rumanisht. Mori disa çmime në konkurse e aktivitete letrare. (Adil Olluri)

HAZIRAJ Abit (1956-). Pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lindi në fshatin Llaushë të komunës së Skënderajt. U mor me sportin e karatesë. Në periudhën 1976-1996 emigroi në Zvicër, ku e vazhdoi shkollimin e karatesë. Ishte pjesëmarrës i 17 garave, në të cilat triumfoi në disiplinën e "Ajkido Shaulin", ku Abiti mban gradën e dytë. Në Japoni për 18 muaj u specializua për armë të ftohta, nga ku u kthye në Zvicër më gradën "Dy Dan". Nga nëntori i vitit 1997 u bë pjesë aktive e UÇK-së. Gjatë luftës mbajti pozitën e komandantit të pikës V në "Kodrën e Topave", nga aty kaloi në shtabin e Brigadës 112 "Arben Haliti", në pozitën komandantit të zbulimit dhe kundërzbulimit, me seli në Turiqec të Skënderajt. Për shkak të veprimtarisë së tij, në korrik të vitit 1998 Gjykata serbe e Prishtinës e dënoi me 20 vjet heqje lirie në mungesë. Pas përfundimit të luftës kreu detyra të ndryshme në komunën e Skënderajt. (Haxhi Ademi)

HAZIRI Hazir Sh. (1981-). Aktor, mësimdhënës. Lindi në Kumanovë, kurse shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2004). Ka luajtur një numër rolesh në teatër dhe në film, prej të cilave duhen përmendur rolet në filmin "Gomarët



HAZIR HAZIRI

e kufirit" (2011), "Shqiptari" (2012), "Kthimi" (2015) etj., pastaj filmat e shkurtër "Liçeni", "Hija e jetës", "Muzgu", "Kthimi" etj. Në teatër, që në hapat e parë të angazhimit të tij u shqua me rolin kryesor në shfaqjen "Kopshti me da-llëndyshe" (2008) në Teatrin "Dodona", ndërsa më vonë luajti një sërë rolesh në shfaqjet e Teatrit Kombëtar të Kosovës (TKK): "Identiteti", "Hamleti", "Oda n'Hamburg", "Jul Cezari", "Nata e dymbëdhjetë", "Lisistrata" etj. Është veçuar me paraqitjen e tij në rol kryesor në shfaqjen "Vdekja e një komisionari" (2014) të TKK. Ka marrë një numër çmimesh me karakter kombëtar e ndërkombëtar, prej të cilave do përmendur çmimi për aktorin më të mirë në filmin "Bodrumi" dhe çmimin special të jurisë për rolin kryesor në shfaqjen "Nata e Zotrave" në Festivalin e Tetarove Ballkanike në Prishtinë etj. Është mësimdhënës i lëndës së aktrimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Besim Rexhaj)

HAZIRI Lulzim (1962-). Poet, gazetar. Lindi në Reçan të Gostivarit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Gostivar. Studioi për makineri në Fakultetin Teknik në Prishtinë. Poezitë e para i botoi në revistat "Zëri i rinisë", "Bota e re", "Fjala" etj., ndërsa në vitin 1989 Shtëpia Botuese "Rilindja" i botoi përmbledhjen e parë poetike "Kënga lind në vetmi". Me këtë veper i solli letërsisë shqipe poezi të ndjeshmërisë urbane. Me përmbledhjet "Kur dyert hapen me zile" (1995) dhe "Dalja nga safari" (2005) vazhdoi të trajtojë dilemat dhe shqetësimet e përditshmërisë urbane. L. Haziri për shumë vjet është aktiv edhe si autor tregimesh, esesh dhe shkrimesh publicistike, veçanërisht për kulturën, që i përfshiu në librat publicistikë "Rokenrolli shqiptar" (2000) dhe "Bardh e zi" (2010), në të cilët shqyrton sintezat muzikore ndërmjet rokenrollit, muzikës popullore dhe artit popullor në përgjithësi. (Fatmir Sulejmani)

HAZIRI Shensi (1912 -1947). Veprimtar antikomunist gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Mramor të Prishtinës. Nga viti 1942 e deri në nëntor të vitit 1944 ishte xhandar në stacionin e Janjevës. Po

atë vit iu bashkëngjit forcave të rezistencës antikomuniste. Formoi çetën e luftëtarëve, kryesisht me bashkëfshatarë të Mramorit. Në mars të vitit 1946 u rrethua nga forcat jugosllave, por arriti ta çante rrethimin. Një muaj më vonë çetës së tij iu bashkëngjit edhe Gjon Serreçi. Bashkë me çetën e Shtyt Marecit siguruan mbarëvajtjen e Kongresit të Lipovicës. Mori pjesë edhe në betejën e Bilushit, mbi Hoçë të Qytetit (gusht 1946). Me çetën e tij u tërhoq edhe Gjon Serreçi, i cili në tetor të vitit 1946 nga Mramori kaloi në Anamoravë. Më pas njësitë serbe ia dogjën shtëpinë dhe ia burgosën tërë familjen. Së fundi u kap në Gadime të Lipjanit. Gjykata Ushtarake e Divizionit të Prishtinës e dënoi me pushkatim. U ekzekutua publikisht bashkë me disa luftëtarë të tjerë, në Taukbashçë më 27 mars 1947. (Zijadin Gashi)

HAZIRI Xhavit (1960-1998). Veprimtar politik, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Druar të Vushtrrisë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Obiliq. Që në moshë të re u përfshi në organizatat ilegale, duke u bërë njëri nga udhëheqësit e strukturave drejtuese të këtyre organizatave. Studio në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim të vitit 1985 u përfshi në këshillin organizativ për bashkimin e organizatave ilegale në Kosovë, duke marrë detyrën e sekretarit për propagandë, informim dhe shtyp. Në dhjetor të vitit 1985 u arrestua dhe më pas u dënua me 9 vjet burg. U lirua pas 5 vjetësh, kur Kroacia, Sllovenia dhe Bosnja i amnistuan të burgosurit politikë. Edhe pas daljes nga burgu e vazhdoi aktivitetin në kuadër të LPRK-së. Më 1991 u zgjodh anëtar i Komiteti Drejtues të LPRK-së. Më 1993 u arrestua sërish dhe u dënua me 5 vjet burg. Pas lirimit nga burgu në vitin 1997, vazhdoi punën për krijimin e njësiteve ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 17 shtator të vitit 1998 u kidnapua nga pjesëtarët e policisë sekrete të Serbisë dhe që atëherë nuk iu gjet asnjë gjurmë. Më 2010 presidenti i Kosovës i ndau Urdhrin "Hero i Kosovës". (Sylë Ukshini)

HEBLER Klaus (Claus Haebler) (1931-). Gjuhëtar, albanist, profesor gjerman. Lindi në Kemnic të Gjermanisë. Profesor i gjuhësisë indoeuropiane në Universitetin e Mynsterit. Interesimet e tij studimore përfshijnë, mes tjerash, iranishten, greqishten e vjetër,



KLAUS HEBLER

makedonishten dhe shqipen. Për shqipen filloi të botojë që në vitet '50. Më 1959 shkroi për rendin e fjalëve në fjali në gjuhën shqipe dhe për shqipen e Ukrainës. Shkroi gjithashtu për kontributin e albanologëve të tjerë si Lamberci ose Bopi. Më 1965 botoi monografinë për të folmen e arvanitëve të Salaminës në Greqi. Diskutoi huazimet e vjetra greke në shqipen dhe redaktoi vëllimin "Gjuhësia historike" (Historische Sprachforschung, 1999). Bënte pjesë në këshillin drejtues të revistës "Shëjzat". Është anëtar i Akademisë së Gëtingenit. (Imri Badallaj)

HEBRENJTË. Dëshmitë më të vjetra materiale për praninë e hebrenjve në Dardani, përkatësisht në Kosovë, vijnë nga koha e dëbimit të tyre nga atdheu i kryehershëm dhe arritjes së një pjese syresh në Ilirik, pra edhe në Dardani. Kjo ardhje do të ketë ndodhur pas disfatës së vitit 135 të e. s., kur një pjesë e çifutëve, bashkë me ushtrinë romake që kishte luftuar në Lindje, apo edhe nëpër shtigje të tjera, kishin arritur edhe në këto anë si skllevër, zejtarë, tregtarë apo si ushtrues zejesh të tjera. Disa burime materiale e dëshmojnë praninë e hebrenjve gjatë shekujve të parë të erës sonë edhe në pjesë të tjera të Ilirikut. Një dëshmi për këtë është një pllakë prej guri me dimensione 57 x 40 cm, e ngjitur në murin rrethues të Patrikanës së Pejës. Pllaka ka një paraqitje figurative, në qendër të së cilës është simboli hebrej i Mogen Davidit, i cili nga të dyja anët ka nga një qiparis dhe nën ta edhe një figurë me tre peshq. Sipas veçorive tipologjike dhe ikonografike, pllaka ka elemente romake, hebreje dhe të krishtera dhe dëshmon praninë e judeo-krishterimit në Dardani qysh para shpalljes së Ediktit të Milanos (313). Përveç kësaj rrase, gurë të tjerë me shenjën e skalitur të Davidit janë gjetur edhe në rrethina të Pejës dhe në katundin Shushicë të Istogut. Ndërkaq, një bashkësi e besimit judaist përmendet në Novobërdë për herë të parë në vitin 1442, dhe kjo mund të jetë dëshmia më e mëtejshme e mesjetës së vonë për hebrenjtë në Kosovë. Në të vërtetë, për praninë e hebrenjve në Novobërdë e në rrethina të saj, dëshmia më e

vjetër është regjistrimi osman i kryefamiljarëve dhe i pronave, i hartuar midis viteve 1566-1574. Në këtë kohë, ndër banorët e qytetit të Novobërdës është regjistruar edhe bashkësia e çifutëve e përbërë nga gjashtë familje. Përveç kësaj, në qytetin e Novobërdës kishte edhe një bashkësi të katalanëve të vjetër, si edhe një bashkësi e hebrenjve e kthyer nga Kastilja. Besohet se hebrenjtë e Novobërdës në krye të herës ishin nga Katalonja e nga Kastilja e Spanjës dhe se në Novobërdë kishin ardhur nga kolonia e hebrenjve të Selanikut. (Skënder Gashi)

HEKURUDHAT E KOSOVËS. Hekurudha e parë në Kosovë është ndërtuar në vitin 1887, në segmentin Kaçanik-Mitrovicë, që ishte pjesë e hekurudhës Selanik-Shkup-Mitrovicë dhe më



STACIONI HEKURUDHOR NË FUSHË-KOSOVË

tej më në thellësi të Gadishullit Ballkanik. Ky segment i hekurudhës bëri që në pikëpamje ekonomike Kosova ta orientonte aktivitetin tregtar nga Shkupi dhe Selaniku. Ndërtimi i hekurudhave në Kosovë vazhdoi edhe midis dy luftërave botërore. Më 1931 u ndërtua hekurudha Mitrovicë-Leshak, si vazhdim i rrugës Shkup-Hani Elezit-Fushë Kosovë-Mitrovicë-Leshak e gjatë 147.7 km, ndërsa më 1934 u ndërtua hekurudha Fushë Kosovë-Prishtinë, e cila më 1949 ka vazhduar në drejtim të Kurshumlisë (Serbi). Më 1936 u ndërtua edhe hekurudha Prishtinë-Pejë, në gjatësi prej 81,262 km dhe në vitin 1963 u ndërtua hekurudha Klinë-Prizren në gjatësi prej 58.4 km. Po ashtu janë ndërtuar dhe disa kilometra hekurudhë industriale (34.5 km), të cilat lidhin linjat kryesore të hekurudhës me kapacitetet xehtare dhe industriale të Kosovës. Pra, marrë në tërësi, para Luftës së Dytë Botërore në Kosovë u ndërtuan 171 km

hekurudhë, ndërsa pas Luftës së Dytë u ndërtuan 162 km. Kosova sot i ka gjithsej 333 km hekurudhë. Në vitet '90 të shekullit të kaluar, hekurudhat e Kosovës u keqmenaxhuan, ngecën në zhvillim dhe pësuan dëmtime. Pas luftës së fundit, me urdhëresë administrative të UNMIK-ut (2002) Hekurudha e Kosovës u organizua si subjekt i përkohshëm për transportin hekurudhor dhe menaxhim të infrastrukturës së hekurudhave në Kosovë. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës (2010) dhe sipas ligjit në fuqi, Hekurudhat e Kosovës ndahet në dy kompani publike: njëra që merr nën administrim infrastrukturën hekurudhore (Infra-Kos) dhe tjetra që merret me operimin e trenave (Train-Kos), e cila që nga viti 2011 ofron shërbime të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Mirëpo, izolimi i gjatë i Kosovës dhe orientimi i transportit ndërkombëtar nëpër vija hekurudhore që anashkalojnë Kosovën, veçmas nga Serbia dhe Maqedonia, e kanë dëmtuar ndjeshëm këtë fushë të komunikacionit dhe të transportit, kështu që Hekurudhat e Kosovës ende funksionojnë me subvencione qeveritare. (Ramiz Livoreka)

HELBIG Robert (1877-1956). Albanolog, gjuhëtar gjerman. Studioi filologji gjermane, romane dhe angleze në Lajpcig. Doktoroi në Lajpcig me temë mbi elementet italiane në gjuhën shqipe. Ishte anëtar i parlamentit gjerman. Në albanologji njihet me studimin "Elementet italiane në gjuhën shqipe" (Die italienischen Elemente im Albanesischen), disertacion, botuar në Lajpcig më 1903, ku trajton italianizmat e shqipes, duke përcaktuar shek. X si cak kohor të fillimit të depërtimit të tyre. Ky studim ende mbetet referencë për këtë problematikë. (Shpëtim Elezi)

HELMIMET MASIVE NË KOSOVË. Në mars të vitit 1990, Kosova u përfshi nga një "epidemi misterioze" me më shumë se 7,400 persona të sëmurë, kryesisht nxënës shkollash, që patën prekje të sistemit nervor, por edhe manifestime të tjera klinike. Helmim me përmasa më të vogla pati edhe një vit më parë, gjatë periudhës 14-24 mars të vitit 1989, në shkollën e mesme "Luigj Gurakuqi" në Klinë, ku ishin prekur rreth 30 nxënës. Instituti Epidemiologjik i Kosovës kishte konstatuar se nuk bëhej fjalë për sëmundje ngjitëse, por dyshohej se sëmundja është shkaktuar nga ndonjë mjet neurotoksik, i



HELMIMET MASIVE MË 1990

përhapur me ajër dhe diagnozën e vërtetë do ta përcaktonte instituti "INKOS" nga Obiliqi, pas analizave të ajrit. Rezultati zyrtar i analizave nuk doli asnjëherë.

Dhe një vit më vonë ndodhi helmimi masiv i nxënësve dhe fëmijëve, kryesisht shqiptarë, midis të cilëve kishte edhe fëmijë të moshës më të re se 10 vjeç (11 prej tyre ishin të moshës 1-5 vjeç). Helmimi ndodhi pas apartheidit të aplikuar në shkollat e Kosovës dhe në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga shteti serb. Më 13 mars të vitit 1990, helmimet apo e ashtuquajtura "epidemia misterioze" u shfaq në gjimnazin "Gj. Gjakoviq" në Podujevë, në turnin e pasdites, ku mësonin nxënësit shqiptarë. Nga data 15 mars, kur filluan të vinin rastet e para në klinikat e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë e deri më 22 mars 1990, numri i të sëmurëve u rrit shumë. Dekani i Fakultetit të Mjekësisë më 22 mars 1990 formoi konsiliumin mjekësor nga tre profesorë shqiptarë dhe tre serbë. Konsiliumi i ekspertëve, pasi vizituan një numër të madh të të sëmurëve, dolën me një raport, në të cilin thuhej se pasqyra klinike e të prekurve është polimorfe, e përcjellë me skuqe të rëndë të fytyrës, me skuqe të syve, takikardi, shtrëngime në stomak, vilanosje, frymëmarrje të vështirësuar, pa prani të sindromit infektiv. U tha se etiologjia e kësaj simptomatologjie do të përcaktohet pas analizave toksikologjike, që do të bëheshin jashtë Kosovës, meqë Kosova nuk kishte laboratorë të tillë. Mjekët serbë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë e firmosën informatën, por më pas u tërhoqën dhe dolën me deklaratat kontradiktore.

Nga kjo "sëmundje misterioze" në Kosovë u sëmurën 7,421 veta, kryesisht të nacionalitetit shqiptar. Shfaqja e sëmundjes kulmoi në

periudhën 22-31 mars 1990 (4,350 raste). Të sëmurët ishin nga të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës. Në vendbanimet me popullsi kryesisht serbe nuk pati të sëmurë. Po ashtu nuk pati raste, ku ishte popullsia krejtësisht shqiptare. Të sëmurë serbë pati fare pak, si në disa fabrika me punëtorë të nacionaliteteve të përziera. Sëmundja u shfaq në shkollat (77.94%), çerdhe fëmijësh (14 ose 0.38%) dhe fabrika (75 ose 2.06%), dhe për 726 (19.92%) të sëmurë mungojnë shënimet e plota për vendin e ngjarjes. Prej 3,645 të të sëmurëve me shënime më të plota, shumica ishin nxënës (77.94%) dhe femra 72.92%), të moshës 1-9 vjeçare ishin 1.88% të rasteve (këtu përfshiheshin edhe 11 të sëmurë të moshës 1-5 vjeçare).

Autoritetet serbe propaganduan se dukuria kishte origjinë psikogjene. Mjekët shqiptarë dhe të huaj e hodhën poshtë këtë pretendim, për shkak se midis të helmuarve kishte raste edhe të moshave të vogla 0-9 vjeç, që nuk janë në gjendje të simulojnë kriza psikogjene. Saktësia e analizave toksikologjike të fëmijëve të helmuar, të kryera në Spitalin Ushtarak të Beogradit, u vu në dyshim nga disa ekspertë ndërkombëtarë. Ndërkohë fëmijët e helmuar u penguan me të gjitha mënyrat për t'u trajtuar në spitale, madje edhe ata që u shtruan në gjendje të rëndë u dëbuan shpejt nga klinikat. Mostrat e gjakut dhe historitë e sëmundjeve të fëmijëve të helmuar u zhdukën. (Simë Dobreci)

HEMP Erik (Eric Pratt Hamp) (1920-). Gjuhëtar amerikan, indoeuropianist, kelto-log, albanist, profesor. Konsiderohet ndër autoritetet më të mëdha botërore të gjuhësisë



ERIK HEMP

indoeuropiane. Interesat e tij kryesore janë gjuhët keltike dhe shqipja, përfshirë dialektet e arbëreshëve të Italisë dhe të Greqisë. Profesor emeritus në Universitetin e Çikagos dhe redaktor i revistës "Anthropological Linguistics".

Lindi në Londër, ndërsa doktoroi në Harvard (1954) me temë për të folmen e arbëreshëve të Vakariçit. Gjithë karrierën punoi si profesor në Universitetin e Çikagos (1950-1991), ku ishte edhe drejtues i departamentit të lingvistikës në periudhën 1966-1969. Ishte drejtor i Qendrës për Studime Ballkanistike dhe Sllavistike

(1965-1991). Ka ligjëruar edhe në Miçigen, Viskonsin, Dablin, Edinburg, Prishtinë, Kozencë, Shkodër, Bon dhe vende të tjera. Ka qenë pjesëmarrës i shpeshtë i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. Për nder të punës së tij janë publikuar gjashtë festshkrifte, i fundit më 2010 nga Universiteti i Kalabrisë. Është doctor honoris causa në Kolegjin Armherst, në Universitetin e Uellsit, në atë të Kalabrisë, të Delhit dhe të Edinburgut. Është anëtar i Akademisë së Shkencave të Danimarkës, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Më 2015 presidentja e Kosovës e dekoroi me medaljen presidenciale të meritave. Ishte pjesë e projekteve të shumta dhe e revistave të ndryshme: drejtues i Atlasit të Gjuhëve Europiane (Atlas Linguarum Europae) që nga viti 1984, këshilltar në Enciclopedia Brittanica (1969–2000), redaktor i revistës “International Journal of American Linguistics”. Për shqipen, përveç artikujve të shumtë, botoi monografinë për fonologjinë e Vakaricit. Njihet për punën e tij në terren. Trajtesat e tij kryesisht përfshijnë gjuhësinë historike dhe të krahasuar. Botoi më se 3,500 artikuj gjithandej nëpër revista të ndryshme. Disa ndër punimet më me ndikim të tij për shqipen janë përmbledhur të përkthyer në “Studime krahasuese për shqipen”, redaktuar nga R. Ismajli më 2007. Në këtë përmbledhje janë artikujt që përfshijnë zhvillimin historik të numërorëve të shqipes, ndikimin e hershëm të sllavishtes në shqipen, kategoritë e numrit në shqipen, mbi të folmet arvanitase të Atikës dhe të Megaridit, laringalet e shqipes, etimologjinë e emrit të qytetit Nish, zhvillimin e o-së në gjuhën shqipen. Po ashtu, diskuton edhe raportet e shqipes me gjuhët fqinje. Studioi raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit të lashtë. Shqipen e konsideron thelb të studimeve ballkanike. Ka shprehur mendimin se shqipja ka afri me baltishten dhe sllavishten, por jo me trakishten. (Lindita Rugova)

HENCI Fehmi (1930-2013). Mjek, pediatër, profesor universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1963). U emërua mjek i praktikës së përgjithshme në repartin e pediatriisë të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Mbaroi specializimin nga lëmi i pediatriisë në Beograd. Punoi si mjek pediatër në Klinikën e Pediatriisë, kurse me formimin e

katedrës së pediatriisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës u zgjodh asistent. Mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së (1980). Më pas u zgjodh docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës së pediatriisë po në këtë fakultet. Mori pjesë në shumë kongrese e seminare dhe publikoi një numër punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Mehmedali Azemi)

HENDBOLLI. Pas futbollit dhe basketbollit është sporti më cilësor kolektiv në Kosovë. Deri në vitin 1948 është luajtur hendbolli i madh, të cilin në Kosovë e solli Bardhyl Zajmi. Përkras



NJË NDESHJE HENDBOLLI

tij kanë qenë edhe Xhavit Spahiu, babai i hendbollit modern, Arsim Fehmiu, Masar Begolli e disa të tjerë. Klubi i parë i hendbollit ishte “Normalisti” i Prishtinës, që u themelua në vitin 1954. Pas tij u themeluan edhe “Kosova” e Prishtinës, “Trepça” dhe “Partizani” i Mitrovicës, “Partizani” i Vushtrrisë, i Ferizajt, i Prizrenit dhe i Gjakovës. Më 20 shtator 1959 u bë mbledhja e parë e Këshillit të Hendbollit të Kosovës me përfaqësuesit e skuadrave. Në vitet ‘70 dhe ‘80 hendbolli në Kosovë u bë sport elit, në sajë të “Borcit” të Ferizajt (sot “Kastrioti”) dhe “Trepçës” së Mitrovicës, në kohën kur liga e ish-RSFJ-së ishte më e forta në botë. Cilësor ishte edhe “Vëllaznimi” i Gjakovës, “Kosova” e Vushtrrisë dhe “Bozhuri” i Gjilanit, që po ashtu bënë gara në ligat elite të asaj kohe. E shquar me këto cilësi, Kosova mori përsipër të organizojë Kampionatin Botëror të të Rinjve, i cili u zhvillua nga 13 deri më 23 nëntor të vitit 1979. Në krye të këshillit organizues ishte akademik Esat Stavileci. Ekipi i tij prej mbi 300 vetash, bëri një punë të shkëlqyer, i cili nga kreu i hendbollit botëror mori notën më të lartë.

Kampionati i parë pas pavarësimit të hendbollit të Kosovës u mbajt në Drenas më 12 tetor të vitit 1991. Garat u zhvilluan në formë lige deri në vitin 1997-1998. Kryetarët e deritashëm të Federatës së Hendbollit të Kosovës ishin: Mustafa Rëzniqi, Miodrag Raiçeviq, Halil Halilaj, Esat Stavileci, Hysni Firza, Gjergj Gjini, Xhafer Lila, Ramadan Bunjaku, Zef Gjoni, Ryzhdi Tytynxhiu, Bozhidar Iliq, Rajko Rakoçeviq, Danjoll Grezda, Ahmet Hoda, Mexhit Devaja dhe Eugen Saraçini. Federata e Hendbollit e Kosovës u pranua në Fedratën Europiane të Hendbollit (EHF) me të drejta të pjesshme, që ndodhi në Kongresin e mbajtur në Budapest të Hungarisë më 16-21 dhjetor të vitit 2004, ndërkaq të drejtat e plota i gëzoi pas Kongresit të mbajtur në Dublin më 19 shtator 2013. (Xhavit Kajtazi)

HEPATITET. Pezmatim i mëlçisë që shoqërohet me dëmtime të qelizave të saj deri në nekrozë. Kanë dekurs akut, por mund të marrin formën kronike, kur procesi patologjik zgjat më shumë se gjashtë muaj, apo një vit. Shkaktarët më të shpeshtë janë: viruset, alkooli, helmimet dhe barnat. Natyra infektive është zbuluar në fund të shek. XIX dhe sot njihen si virusi i hepatitit A, B, C, D, E etj. Hepatitet toksike shkaktohen nga alkooli, tetrakloruri i karbonit, kërpudhat dhe disa barna. Klinikisht sëmundja karakterizohet me paraqitje të simptomave të përgjithshme, duke u shoqëruar me shfaqjen e verdhëzës (ikterit) në lëkurë, të bardhët e syrit (sklerë), ngjyrë e errët e urinës dhe e zbehtë e fecesit. Mjekimi është simptomatik, kurse parandalimi i sëmundjes bëhet me vaksinim. Në shfrytëzim janë vaksina kundër hepatitit A dhe atij B. Në Kosovë vaksinimi kundër hepatitit B është i obliguar për të gjithë fëmijët dhe për disa profesione të caktuara: mjekë, stomatologë, laborantë etj. Kosova konsiderohet vatër endemike për hepatit A, ku janë të njohura edhe epidemitë familjare. Brenda vitit regjistroheshin mbi 200 raste të hepatitit A. Rastet e hepatitit B dhe C janë në rritje të vazhdueshme, duke ndjekur trendin botëror të zhvillimit të sëmundjes. Brenda vitit regjistroheshin rreth 100 raste të hepatitit B dhe C. (Isme Humolli)

HERBERT Obri (Aubrey) (1880-1923). Diplomati dhe deputet britanik, publicist, i njohur për angazhimet e tij për çështjen shqiptare. Studioi në Kolegjin Eton dhe atë të Balliolit, në



HERBERT OBRI

Oksford. Në vitin 1904 u emërua atashe nderi në ambasadën britanike në Stamboll, ku ra në kontakt me shqiptarët. Prej asaj kohe iu përkushtua çështjes kombëtare shqiptare, njohjes dhe sigurimit të mbështetësve për të në opinionin politik e publik britanik e më gjerë. Në vitin 1907 nisi udhëtimet nëpër viset shqiptare, ku u njoh me popullsinë dhe mësoi gjuhën shqipe. Gjatë zhvillimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), me iniciativën e tij u themelua Komiteti Shqiptar (Albanian Committee), i cili këshilloi delegacionin shqiptar në negociatat me Fuqitë e Mëdha. Në fillim të vitit 1918, Komiteti u shndërrua në Shoqatën Anglo-Shqiptare (Anglo-Albanian Association). Në cilësinë e kryetarit të kësaj shoqate, A. Herbert iu përkushtua tërësisht mbrojtjes së të drejtave të kombit shqiptar dhe krijimit të një shteti të pavarur në territoret etnike. Në vitin 1916, Federata panshqiptare “Vatra” e ngarkoi delegat nderi në Europë, funksion që e mbajti edhe në Konferencën e Paqes në Paris (1919). Njëkohësisht ishte edhe këshilltar i delegacionit zyrtar shqiptar në këtë konferencë. A. Herbert botoi shumë artikuj në shtypin e kohës në mbështetje të Shqipërisë dhe shqiptarëve, si dhe lobi për ta pranë institucionet ndërkombëtare, veçanërisht atyre britanike. Është autor i vëllimit “Unë vetë, memoar i udhëtimeve në lindje” (Ben Kendim, a record of Eastern Travels), botuar më 1924. Biografia e tij u botua nga e mbesa, më 1983 në Londër nën titullin “Burrri që quhej Grenmentël” (The man Who was Greenmantle). Fjalimet parlamentare, artikujt publicistikë dhe ditari i mbajtur nga A. Herbert u botuan më 2011 në librin “Miku më i madh i Shqipërisë: Aubrey Herbert dhe bërja e Shqipërisë moderne: Ditare dhe letra 1904-1923” (Albania’s Greatest Friend -Aubrey Herbert and the making of modern Albania: Diaries and Papers 1904-1923). Për kontributin e tij A. Herbert u dekorua në Shqipëri me Urdhrin “Naim Frashëri”. (Ledia Dushku)

HERMA E LIBERIT. Skulpturë e punuar në mermer, e cila paraqet Hermën gjysmëtrupore. I atribuohet Liberit, pandan të Dionisit, i cili më pas njëjtësohet me Bakun, hy romak i rritjes


dhe kultivimit të rrushit, agrikulturës dhe mbrojtës nga mësyshi. Emërtimi i referohet hyjnisë së pjellshmërisë, fatit dhe mbrojtësit të rrugëve e kufijve dhe kryesisht është lyer me vaj ulliri dhe është bërë dhuratë. Ka gjatësi prej 58.8 cm dhe koka ka gjatësinë prej 21 cm. Skulptura ka dhe fallusin, që simbolizon forcat riprodhuese të natyrës. U zbulua pranë portikut të tempullit antik të Ulpianës, në kompleksin e banjës romake, në mes termës dhe tempullit (2012). Është ripërdorur për ndërtimin e kanalit të ujit të termës dhe datohet në shek. I-IV. Forma e Hermës ka origjinë greke, por është adaptuar në artin romak. Është vendosur në vende publike dhe në udhëkryqe e rrugë të frekuentuara, duke shërbyer si tregues i kufijve, palestrave, gimnazioneve dhe tempujve. (Milot Berisha)

HETEMAJ Përparim (1986-). Futbollist. Lindi në Skënderaj. Nisi karrierën në vitin 1993 te gjeneratat e reja të Helsinkit. Në vitin 2004 iu bashkua ekipit të parë dhe menjëherë për një edicion u huazua te “Klubi 04”. U kthye te “Helsniki” dhe luajti deri në vitin 2006, kur fitoi Kupën e Finlandës, më vonë kalon te skuadra e njohur greke “AEK” i Athinës. Gjatë kohës sa ishte pjesë e “AEK-ut” (2006-2009) për një vit luajti si huazim tek “Apollon Kalamarisi” (2008). Në vitin 2009 kaloi në Holandë te skuadra e “Twentes” dhe pas një viti karrierën e vazhdoi në Itali, te skuadra e “Brescias”, që ishte pjesë e Serisë B. Qysh në edicionin e parë, me skuadrën “Brescia” kaloi në Serinë A. Në vitin 2011 kaloi te Kijevo (Chievo), për të cilën regjistroi mbi 100 paraqitje dhe është njëri prej mesfushorëve të dalluar në kampionatin italian. (Tahir Sopi)

HETEMI Kemajl (1968-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Ferizaj. Në muajin korrik të vitit 1998 u bë anëtar i shtabit lokal të UÇK-së në Krojmir. Po atë muaj mori pjesë në luftimet kundër forcave serbe në afërsi të fshatit Fushticë, ndërsa pak ditë më vonë mori pjesë në luftën për mbrojtjen e Zborcit. Në korrik të vitit 1998 me shumë bashkëluftëtarë të tjerë u përfshi në përbërjen e Nënzonës Operative të Nerodimes në Jezerc. Me urdhër të komandës së kësaj nënzona u caktua zëvendëskomandant i pikës së parë të UÇK-së në Jezerc. U vra më 28 shtator në luftë kundër forcave të ushtrisë dhe të

policisë serbe, në mbrojtje të pozicioneve të UÇK-së. (Ruzhdi Jashari)

HETEMI Mehdi (1945-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Prelez të Jerlive, komuna e Ferizajt. Diplomoi në Fakultetin Juridik të Prishtinës, kurse në vitin 1974 kreu studimet pasuniversitare në



MEHDI HETEMI

Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit. Në vitin 1973 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP) për lëndët juridikocivile, kurse në vitin 1976 u zgjodh docent për lëndën e drejta ekonomike. Doktoroi në Fakultetin Juridik të UP-së. Realizoi qëndrime studimore në Britani të Madhe dhe në SHBA. Është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (nga viti 1983). Botoi punime të shumta në revista të ndryshme shkencore, vendore dhe ndërkombëtare dhe disa tekste universitare: “E drejta, me njohuritë themelore të së drejtës afariste” (1996), “Detyrimet dhe kontratat” (1998), “Pagesat ndërkombëtare në transaksionet afariste” (2001), “E drejta ndërkombëtare afariste” (2007) etj. (Nerxhivane G. Dauti)

HIDROCENTRALET. Centrale elektrike ku energjia e gravitetit të ujit shndërrohet në energji elektrike. Kosova ka potenciale të kufizuara të ujit për prodhim të energjisë elektrike. Hidrocentrali i parë në Kosovë u ndërtua në Prizren në vitin 1928, me një kapacitet të vogël prej 2x 150 kW dhe shërbeu kryesisht për ndriçimin e rrugëve. Më vonë u ndërtuan disa hidrocentrale me kapacitete të ndryshme, siç janë: Lumëbardhi me kapacitet prej 8 MW (1936, riparuar më 2003), Dikance 2 MW (1957, riparuar 2011), Radavci 0.84 MW (1935, riparuar 2010), Istogu 0.84 MW (1948, riparuar më 2010). Prodhimi mesatar vjetor i energjisë i këtyre HC-ve sillet rreth 47 GWh. Të gjitha këto hidrocentrale kanë qenë pronë e Elektroekonomisë së Kosovës, ndërkaq tani u janë dhënë me koncesion firmave private për një periudhë 20-vjeçare. Hidrocentrali i Ujmanit është pronë e Ndërmarrjes Publike “Ibër Lepenc” dhe është ndërtuar në pendën e liqenit të Ujmanit (1983) me kapacitet prej 35 MW dhe prodhim vjetor



HIDROCENTRALI I UJMANIT

rreth 102 GWh. Në bazë të studimeve të bëra për potencialet e energjisë së ujit për ndërtimin e HC-ve të reja është vlerësuar se potenciali hidroteknik, ekonomikisht i shfrytëzueshëm në rrjedhjet e Drinit të Bardhë, të Ibrit, të Moravës, të Lepencit, të Llapit është 680 GWh/në vit dhe është potencial i rëndësishëm për prodhimin e energjisë elektrike. Njëri nga më të rëndësishmit është studimi i fizibilitetit për HC-në e Zhurit, si i vetmi që është zgjedhur për ndërtim në planin afatmesëm të zgjerimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës. HC i Zhurit ka karakteristikat e një centrali të pikut me kapacitet të madh depozitues (rreth 105 milionë metra kub), në një lartësi të madhe, e cila është e favorshme për ndërtimin e një centrali të madh. Sipas një varianti, fuqia e instaluar e këtij hidrocentrali do të jetë 293 MW, me prodhim vjetor 398 GWh. Një studim i veçantë është bërë për potencialet ujore të lumenjve në gjithë territorin e Kosovës. Sipas analizave teknike e ekonomike janë gjetur 18 lokacione të përshtatshme për ndërtimin e HC-ve të vogla me një kapacitet të përgjithshëm prej 64 MW. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka lëshuar autorizime për HC-të e reja në lokacione të ndryshme me kapacitet të përgjithshëm 28 MW, të cilat janë në ndërtim e sipër. Pjesëmarrja e energjisë së prodhuar nga HC-të në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë është e vogël dhe arrin rreth 2%. Qeveria e Kosovës i ka caktuar

kuotat për ndërtimin e kapaciteteve nga energjia e ujit si burim i ripërtërishëm, me qëllim të arritjes së një prodhimi prej 20% deri në vitin 2020, i cili është obligim që rrjedh nga direktivat përkatëse të Bashkimit Europian. (Ali Hamiti)

HIDROSISTEMI "IBËR-LEPENC" Ndërmarrje komplekse, shoqëri aksionare në pronësi publike me seli në Prishtinë, e cila furnizon industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë me ujë të



HIDROSISTEMI "IBËR-LEPENC"

papërpunuar, si dhe prodhon energji elektrike nga Hidrocentrali i Ujmanit. U themelua me vendim të Kuvendit të Kosovës në vitin 1967, ndërsa në vitin 1986 u konstitua si ndërmarrje shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës të këtij sistemi kompleks. Ndërtimi i hidrosistemit "Ibër-Lepenc" ishte paraparë të bëhej në dy faza: faza e Ibrit, e cila ka përfunduar në vitin 1986 dhe faza e Lepencit, që nuk është realizuar. Pas luftës Hidrosistemi "Ibër-Lepenc" është transformuar në ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Ndërmarrja përfshin disa objekte me rëndësi, si Penda e Ujmanit (mundëson akumulimi i ujit në sasi prej 375 mil. m³ që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike), furnizimi i industrisë me ujë të papërpunuar (KEK-u dhe Ferronikeli) si dhe furnizimin e ujësjellësve rajonalë në Mitrovicë dhe Prishtinë me ujë të papërpunuar. Një sasi e

konsiderueshme e ujit shfrytëzohet për ujitjen e tokave bujqësore. Objektet e ndërmarrjes shtrihen në territorin e 7 komunave (Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Fushë- Kosovë dhe Glogoc), posedon kanale kryesore në gjatësi rreth 146 km, 14 stacione pompimi për ujitje, 4 objekte ndarëse, rrjeti nëntokësor për ujitje në gjatësi 766 km si dhe rreth 120 km largpërçues. (Skënder Kaçiu)

HILL Kristofer (Christopher R. Hill) (1952-).

Diplomat amerikan. Shërbeu në vende të ndryshme të botës. Ishte pjesë e ekipit që negocioi marrëveshjen e paqes në Bosnjë. Punoi ngushtë me diplomatin Riçard



KRISTOFER HILL

Hollbruk dhe shërbeu si zëvendës i tij në bisedimet e paqes së Dejtonit (1995). Në periudhën 1996-1999 ishte ambasador në Maqedoni, ndërsa në vitet 1998-99 i dërguar i posaçëm për Kosovën. Duke qenë i angazhuar në negociata ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë, ofroi katër propozim-marrëveshje (tetor - dhjetor 1998 - janar 1999), të cilat ofronin zgjidhje kalimtare për krizën e Kosovës, por që nuk u pranuan nga pala shqiptare dhe serbe. K. Hill ishte ndërmjetës në Konferencën e Rambujesë (shkurt-mars 1999) dhe, bashkë me ambasadorin e Bashkimit Europian, V. Petritç dhe atë rus, B. Majorski, përcaktuan përmbajtjen dhe strategjinë e bisedimeve. Në librin e tij autobiografik, "Pararojë: jeta në vijat e para të fronit të diplomacisë amerikane" bën fjalë edhe për angazhimet e tij rreth Kosovës, gati për një dekadë. Më 19 qershor 2013 Universiteti i Prishtinës i dha titullin "Doctor Honoris Causa", në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës. (Sylë Ukshini)

HIMA Dervish (1875-1928). Pseudonim i Ibrahim Mehmet Naxhiut, veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në Ohër. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Manastir dhe Selanik. Studioi për mjekësi ushtarake në Stamboll, por u detyrua t'i ndërpreste studimet, për shkak të përkrahjes së lëvizjes xhonturke dhe të përkrahjes së çështjes kombëtare shqiptare. Nga viti 1895 lëvizi fshehtas nga një vend në tjetrin, duke propaganduar



DERVISH HIMA

çështjen shqiptare me artikuj e kontribute intelektuale. D.Hima kundërshtoi pushtetin osman në Shqipëri edhe përmes një numri manifestesh radikale që bënë thirrje për luftë të përgjithshme kundër Portës. Për këtë arsye lëvizjet e tij ndiqeshin me vëmendje nga autoritetet osmane, të cilat e burgosën disa herë. Në Bukuresht shkoi më 1897, ku botoi revistën "Pavarësia e Shqipërisë", e cila më 1898 doli shqip, frëngjisht dhe rumanisht. Në vitin 1899 u largua nga Rumania për në Romë, ku bashkëpunoi me Mehmet Frashërin për botimin e gazetës së përdyjavshme "Zani i Shqipënisë" në shqip dhe frëngjisht. Më 1903 botoi gazetën e përdyjavshme "L'Albanie" në Gjenevë, e cila më pas doli çdo muaj nga viti 1905 deri më 1906 në Bruksel. Më 1909 në Stamboll, bashkë me Hilë Mosin botoi të përvajshmen "Shqipëtar-Arnavud" në shqip dhe turqisht, që financohej nga Austro-Hungaria. Gazeta u ndalua në fund të vitit 1910. D.Hima udhëhoqi çetën e studentëve gjatë kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. Në vitet 1913-1918 në mërgim e pastaj në atdhe u angazhua për mbrojtjen e shtetit të pavarur dhe për zhvillimin e arsimit, kulturës e shtypit shqiptar. Më 1917 u emërua inspektor arsimit në qarkun e Tiranës nga autoritetet austro-hungareze, kurse më 1920 ishte drejtor i parë i Zyrës së Shtypit në Shqipëri. Vdiq në Tiranë. (Jusuf Bajraktari).

HIMA H. Faik (1942-). Mjek, internist, kardiolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Përfundoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë



FAIK HIMA

në Beograd (1969), ku specializoi për mjekësi interne (1977), ndërsa një vit më vonë kreu studimet pasdiplomike për kardiologji. Punoi në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme. Ndërkohë u emërua asistent i lëndës mjekësia interne në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1984 qëndroi disa muaj në Qendrën për sëmundje kardiovaskulare "Texas Heart

Institute” në Hjuston, SHBA. Mbrojti tezën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1987, më pas u emërua docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i lëndës mjekësia interne. Më 1994 u zgjodh redaktor i revistës shkencore-profesionale të Shoqatës së Mjekëve të Kosovës “Praxis medica”. Kreu detyra dhe funksione në katedrën e mjekësisë interne dhe në Fakultetin e Mjekësisë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Bedri Zahiti)

HIMA Izet (1938-1999). Mjek, kirurg, dëshmor. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Gjakovë, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Beograd (1964). Në vitin 1965 u punësua në Qendrën Mjekësore “Isa Grezda” të Gjakovës. Ishte ndër kuadrot e para të kësaj fushe në Gjakovë. Specializoi për kirurgji të përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1973. Ishte drejtor i Spitalit të Përgjithshëm të Qendrës Mjekësore “Isa Grezda”, pastaj drejtor gjeneral i Qendrës Mjekësore dhe shef i repartit të kirurgjisë, deri më 24 mars 1999, kur u sulmua nga paramilitarët serbë dhe u masakrua para derës së shtëpisë. (Ali Llunji)

HIMA Vera (1941-). Spikere televizive. Lind në Shqipëri. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë. Pas gjimnazit nisi studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Sarajevës, i vazhdoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit. Më 1966 nis të punojë si folëse e parë e emisioneve shqip “Pasqyra televizive” të Televizionit të Beogradit, ku punoi deri kur filloi punën Televizioni i Prishtinës (1975). Në Televizionin e Prishtinës punoi deri në korrik të vitit 1990, deri në mbyllje nga Serbia. Përveç punës së spikeres, ishte edhe autore emisionesh televizive. U nderua me çmime dhe mirënjohje. (Nehat Islami)

HIMNI I KOSOVËS. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, për hyrjen në fuqi të Kushtetutës së saj nevojitej plotësimi i simboleve shtetërore. Ndër to ishte edhe himni shtetëror. Nga 134 propozimet e arritura për himn, Kryesia e Kuvendit dhe drejtuesit e grupeve parlamentare zgjodhën vetëm një: melodinë me shifrën “Europa”, votuar nga 72 vota prej 120 pjesëmarrësve në seancë, që u

miratua më 11 qershor 2008. Himni i zgjedhur është kompozuar nga kompozitori i mirënjohur shqiptar nga Kosova, Mendi Mengjiqi, pa tekst, i paraparë kështu në pakon e Marti Ahtisarit. Kompozitori është deklaruar se e posedon edhe tekstin, i cili është shfaqur publikisht në mënyrë jozyrtare. Ideja e himnit shtetëror të Kosovës ishte bartja e mesazhit të paqës ndërmjet të etniciteteve me anë të tingujve muzikorë. Ky himn, si vepër solemne dhe përfaqësuese e popullit, vazhdon të interpretohet pa tekst. (Rreze Kryeziu-Breznica)

HIMNI KOMBËTAR. Këngë patriotike “Rreth flamurit të përbashkuar”, e cila ekzekutohet në raste solemne dhe, bashkë me flamurin kombëtar, identifikojnë shtetin dhe kombin shqiptar në manifestime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Teksti i këngës është shkruar nga poeti Aleksandër Stavre Drenova-Asdreni (1872-1947), i cili më 1907 në Bukuresht të Rumunisë e përshtati poezinë e tij me muzikën marshuese të kompozitorit rumun Ciprian Porumbescu (1853-1883), me qëllim që të përgatitej prej koristëve shqiptarë në Bukuresht për t’u dërguar në Korçë përmes atdhetarëve Spiridon T. Ilo (tenor) e Hilë Mosi (poet), që të këndohëj si himn kombëtar. Përfshirja e dy simboleve bazë të një shteti ishin qëllime kulmore, me të cilat po pagëzohej shteti shqiptar në nëntor të vitit 1912, si simbole unike për kombin. Vargjet “Në dorë armët do t’i mbajmë/Të mbrojmë Atdhenë në çdo kënt/Të drejtat tona ne s’i ndajmë/Këtu armiqtë s’kanë vent” ishin thirrje për mbrojtjen e integritetit teritorial e shpirtëror shqiptar, kërkesë sublimë kundër copëtimit të Shqipërisë, që nënkuptonte idealin për pavarësinë e atdheut. Në ceremoninë e shpalljes së Pavarësisë në Vlorë u këndua himni i Asdrenit me titull “Betimi m’i flamur” nga delegatët, shoqëruar nga banda e lirisë dhe me brohoritje të popullit: “Rroftë Shqipëria jonë e lirë!” Titulli “Betimi m’i flamur”, pati shkruar më pas poeti L. Poradeci, “është koncept dhe akt etnikisht shqiptar, sado askush n’ato çaste historike s’mendonte që kjo këngë do të bëhet himn i ardhshëm kombëtar”. Në “The Guinness Book of music” (1981) shkruan se himni “Rreth flamurit të përbashkuar” është pranuar himn kombëtar i shqiptarëve me vargje të Asdrenit dhe me muzikën e kompozitorit rumun C. Porumbescu dhe se përpara se kjo poezi të

bëhej himn i shqiptarëve, i pëlqeu popullit më 1912 me trajtë e frymë. Me të luftuan çetat kryengritëse dhe u flijuan për Atdhe, me të u ngrit flamuri në Vlorë nga Ismail Qemali. Në 10-vjetorin e Pavarësisë (1922), nga Ministria e Arsimit qe trajtuar himni me qëllim që të jetë i tëri me poezi e muzikë të autorëve vendorë, por tekstet e arritura nuk i plotësuan kriteret. Në 25-vjetorin e Pavarësisë (1937), megjithë mendimet që e mbronin himnin “Rreth flamurit të përbashkuar” u shtrua kërkesa e bërjes së një himni tjetër dhe u formua komisioni (P. Qiriazi, M. Llogoreci, J. Papahristo, E. Vlora, K. Gurakuqi, T. Selenica, Z. Xoxa) dhe juria (Atë Gj. Fishta, M. Frashëri, K. Cipo). Në konkurs morën pjesë kompozitorët: L. Filja, K. Kono, P. Dingu dhe italiani E. A. Mario. Fituese doli poezia “O flamur yll i lirisë” i autorit Beqir Qela. Për muzikë qe shpallur konkurs tjetër, ku doli fitues kompozitori italian E. A. Mario (pseudonim i Giovanni E. Gaeta, 1884-1961). Ndërkohë Himni i Asdrenit “Rreth flamurit të përbashkuar” vazhonte rrugëtimin ndër shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore u bënë përpjekje për të shkruar një himn kombëtar me autorë vendorë: më 1945/46 poezia me e mirë u zgjodh “Himni i Shqipërisë së re” e S. Luarasi dhe muzika e K. Konos, por nuk ndodhi ndryshimi. Në konkursin tjetër, më 1976 morën pjesë poetët I. Kadare, F. Arapi, Xh. Spahiu dhe kompozitorët Ç. Zadeja, F. Ibrahim, N. Zoraqi, P. Gaci, T. Hoshafi etj. U zgjodhën muzika e Ç. Zadesë (e para) dhe N. Zoraqit (e dyta). Por sërish nuk ndodhi ndryshimi, ndërkohë që himni “Rreth flamurit të përbashkuar” vazhdoi jetën ndër masat popullore. Edhe më 1992, Komisioni i simboleve i Kuvendit Popullor të Shqipërisë doli me debat me vetëm një propozim për himn të ri, me tekst të L. Temalit dhe muzikën e F. Lleshit, por sërish himni mbeti i pandryshuar. (Zeqirja Ballata)

HIPOTEKA. Mjet për sigurimin e një kërkesë apo pagese të kreditorit, e ngarkuar ndaj një prone të paluajtshme, me të cilën kreditori fiton të drejtën që të fillojë procedurën përmbartimore për t'i hequr titullin pronësor pronarit hipotekëlënës me qëllim të realizimit të inkasimit të pagesës. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë hipoteka krijohet me kontratë apo me ligj dhe prodhon efekt ndaj palëve të treta vetëm pasi të regjistrohet në regjistrin për të drejtat e

pronës së paluajtshme në komunën ku është e vendosur prona e paluajtshme e ngarkuar me hipotekë. Ligjet e Kosovës parashohin se hipoteka e krijuar me kontratë duhet të përmbajë elementet qenësore të kërkuara me ligj dhe të jetë e noterizuar. Ligjet parashohin gjithashtu që hipoteka e ngarkuar mbi një pronë të paluajtshme shtrihet në të gjitha pjesët e pronës së ngarkuar, përfshirë edhe të gjitha ndërtesat mbi tokë apo strukturat e tjera të lidhura në mënyrë të pandashme me tokën. Pra, ligjet e Kosovës përcaktojnë se hipoteka mund të ngarkohet në mënyrë të pavarur edhe mbi një ndërtesë, pjesë të ndërtesës apo banesë, në rastet kur këto njësi pronësore janë të ndara dhe të regjistruara në mënyrë të ndarë në regjistrin për të drejtat e pronës së paluajtshme. Ligji në fuqi në Kosovë parashih se mbi një pronë të paluajtshme mund të ngarkohen disa hipoteka. Në këtë rast, sipas ligjit në fuqi, përveç nëse kreditorët janë pajtuar ndryshe, hipotekat renditen sipas kohës së krijimit, ku hipoteka e mëhershme ka rend më të lartë në raport me hipotekën e krijuar më vonë. Me ligj është përcaktuar se hipoteka paraqet titull ekzekutiv, i cili mund të përmbartohet me procedurë përmbartimore. (Dastid Pallaska)

HISARI I KASTERCIT. Vendbanim parahistorik, antik dhe mesjetar, i njohur me toponimin Hisar. Gjendet mbi një kodër me pozicion të rëndësishëm gjeostrategjik (508 m), në mes të fshatrave Nishor dhe Kastërc (Suharekë, 1.6 ha). Nga veriu dhe perëndimi mbrohet nga natyra dhe, si rrjedhojë, nuk ka mure rrethuese, ndërsa në lindje dhe jug është fortifikuar me dy linja të murit me gjerësi prej 1.30-1.80 m, të ndërtuar me teknikë opus incertum. Janë konstatuar dhe struktura të tjera arkitektonike: kompleksi i madh banimi, kisha e tipit trikonke dhe një repertor i pasur i materialit të lëvizshëm arkeologjik. Prania e kishës trikonke, e para e këtij lloji në Kosovë, dëshmon se vendbanimi ishte qendër e rëndësishme kishtarë. Gjurmët e para të jetës i përkasin epokës së eneolitit, duke vazhduar gjatë epokës së bronzit e të hekurit, antikës dhe mesjetës, deri në shek. XII-XIII. U identifikua dhe të dhënat fillestare u botuan nga E. Shukriu, ndërsa gërmimet arkeologjike u zhvilluan nga Muzeu i Kosovës. Mund të identifikohet me fortifikatën Kasteliona të shënuar nga Prokopi (“Mbi ndërtimet”). (Arben Hajdari)

HISARI I SUHAREKËS. Vendbanim shumë-shtresor parahistorik. Është i vendosur në një tarracë lumore në dalje të Suharekës, në anën e djathtë të magjstrales Suharekë-Prizren. I takon tipit të vendbanimeve të ulëta kodrinore parahistorike, që mbrohej në tri anë nga pjerrtësia e terrenit dhe vetëm nga jugu kishte qasje të lehtë (180 x 90 m). Gërmimet e viteve 1961-1963, si dhe ato me karakter kontrolli 1978 (Muzeu i Kosovës) dhe 2003-2004 e 2007 (Instituti Arkeologjik i Kosovës), kanë nxjerrë në shesh shtresime horizontale dhe vertikale (4 m) me jetëgjatësi nga neolitit i vonë deri në përdhën e hekurit, por ka edhe gjetje të periudhës paraurbane dhe të antikitetit të vonë. Hisari I (neoliti i vonë) shfaq gërshtimin e kulturës së Vinçës dhe të asaj bregdetare Danilo-Reshtan. Hisari IIa (eneoliti i hershëm I) dhe Hisar IIb (eneoliti i hershëm II) përfaqësohen më shumë me qeramikë gri në të zezë, me brumë të pastër dhe lustër të ngjashme me qeramikën e grafituar të zonave verilindore. Dominon qeramika me profil S dhe ka zbukurime me trekëndësha të vargëzuar, si vazhdim i elementeve neolitike. Horizonti tre dhe katër është vazhdimësi e traditës së mëparshme, por ka dhe shfaqje të enëve me buzë të trashura nga brenda, të dekoruara me kanelyrë. Hisar Iic (eneoliti i zhvilluar) përfaqësohet nga dy depozitime eneolitike të kulturës Kostolac, me forma tipike të filxhanëve masivë me vegjë mbi buzë dhe Hisari përfaqëson lokalitetin më jugor të prezencës së këtij grupi kulturor në Ballkan. Hisar IIIa (bronzi i hershëm) është formuar mbi një hiatus dhe është e përfaqësuar nga qeramika trashanike, tasa dyvegjëshe dhe zbukurim pseudo-barbotin. Hisari IIIc (bronzi i vonë) përfaqësohet nga pjata tipike konike me buzë të trashura nga brenda dhe të zbukuruara me kanelyra, turbandish. Hisari IVa-c (hekuri i hershëm, shek. XI-IX p.e.r.) ka të riprodhuara trajta të enëve të epokës së bronzit me pak nuanca të reja, siç është shfaqja e enëve të zbukuruara me instrument të dhëmbëzuar. Në fazën fundore të epokës së hekurit të mesëm ka dhe forma të qeramikës adriatike-mesdhetare. Hisar IVb (shek. VIII-VII p.e.r.) dhe Hisari IVc dhe Hisari Va (faza paraurbane dardane, shek. VI-IV p.e.r.) paraqesin kulturë dardane dhe kjo e fundit sjell përdorimin e qarkut të poçarit dhe enë me trajta vendore e imitime të enëve greke. Duket se Hisari Vb sjell elemente të periudhës qytetare (shek. IV-II p.e.r.), ndërsa fragmentet

e antikitetit të vonë të gjetura në shtresat bujqësore sjellin në përfundim se Hisari ishte një vendbanim i fortifikuar i shek. IV-VI (Hisar VI). (Haxhi Mehmetaj)

HISTORIA E ARSIMIT NË KOSOVË. Historia e arsimit në Kosovë deri në vitin 1912 është pjesë integrale e historisë së arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar në përgjithësi. Pushtuesit e ndryshëm sollën edhe kulturën, edukatën dhe arsimin e tyre edhe në këtë hapësirë. Në shek. XVI, në trevat shqiptare paraqiten shkollat katolike shqipe, ndërsa në fund të shek. XIX shkollat e para kombëtare shqipe për djem dhe për vajza. Në kohën e luftërave ballkanike, Kosovën e pushtojnë forcat serbo-malazeze, të cilët u angazhuan kundër shkollës dhe gjuhës shqipe dhe për themelimin shkollave serbe. Gjatë Luftës së Parë Botërore, në zonat e pushtimit austro-gungarez të Kosovës hapen rreth 50 shkolla shqipe, me rreth 4,000 nxënës. Në vitet 1918-1941, kur Kosova ripushtohet dhe administrohet nga Mbretëria Jugosllave, shqiptarëve u mohohen të drejtat themelore, duke përfshirë edhe atë për arsimim në gjuhën amtare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1944), në kohën e pushtimit italian, në Kosovë u hapën shumë shkolla fillore dhe disa shkolla të mesme, si pjesë integrale e sistemit të arsimit në Shqipërinë Etnike. Pas Luftës së Dytë Botërore Kosova u fut nën administrimin jugosllav, fillimisht si provincë e Serbisë. Në këtë periudhë u hapën shumë shkolla fillore, të mesme dhe të larta me mësim në gjuhën amtare, gjë që ndikoi në shtrirjen dhe masivizimin e arsimit edhe në gjuhën shqipe. Më 1970 u themelua Universiteti i Prishtinës. Me ndryshimet kushtetuese të RSFJ-së të vitit 1974, sistemi i arsimit në Kosovë fitoi autonomi të gjerë, ndonëse ishte pjesë integrale e sistemit arsimor jugosllav, që synonte “edukimin në frymën e patriotizmit socialist jugosllav.” Me gjithë pavarësinë juridike të Kosovës dhe të sistemit të arsimit të saj, Serbia vazhdimisht ushtronte tryzni mbi arsimin shqip në forma të ndryshme, me qëllim të kufizimit të mësimin të kulturës dhe historisë shqiptare dhe të zgjerimit të përmbajtjeve nga historia dhe kultura serbe e jugosllave. Kjo fushatë kundër shkollës dhe arsimit shqip në Kosovë u intensifikua sidomos nga vitit 1981, për të kulmuar me shkatërrimin e autonomisë së Kosovës dhe pavarësisë juridike të saj nga

Serbia. Në vitin shkollor 1990/91 Serbia aplikoi masat e dhunshme në arsimin shqip në Kosovë, me ç'rast nxënësit shqiptarë u dëbuan nga objektet e tyre, me mijëra arsimtarë shqiptarë u përjashtuan nga puna, u ndërpre financimi i arsimit, u suprimuan organet legale etj. Në vitin 1991 arsimit shqip në Kosovë, në rrethana të jashtëzakonshme, shkëputet përfundimisht nga sistemi arsimor serb dhe sendërtohet si një sistem arsimor i pavarur në të gjithë segmentet. Qeveria e Republikës së Kosovës në emigrim, më 1994, nxori "Dekretligjin për drejtimin e përkohshëm të veprimtarisë edukativo-arsimore në Republikën e Kosovës", "Dekretligjin mbi shkollimin e lartë", si dhe disa rregullore të arsimit. Në vitin shkollor 1995/96 filluan të përdoren edhe tekste të përbashkëta në Kosovë dhe në Shqipëri. Përveç institucioneve shtetërore të Kosovës, kontribut të veçantë në mbijetesën, organizimin dhe pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë dhanë sindikatat e arsimit, Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" etj. Asokohe sistemi i arsimit shqip në Kosovë përfshinte 452 shkolla fillore të plota, 67 shkolla të mesme dhe Universitetin e Prishtinës me 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta. Kishte rreth 400,000 nxënës dhe studentë dhe rreth 21,000 mësuesdhënës. Kjo zgjati deri në vitin 1999, kur Kosova u çlirua nga Serbia. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Kosova u administrua nga UNMIK-u, në bashkëpunim me institucionet demokratike vendore. Në këtë kohë, krahas përpjekjeve për tejkalimin e pasojave të luftës dhe konsolidimit të sistemit të arsimit, filloi edhe reformimi i tij. Institucionet vendore, gradualisht, morën përgjegjësitë kryesore për arsimin në Kosovë, për të arritur kështu deri të shpallja e pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Që atëherë arsimit në Kosovë funksionon si sistem arsimor i një shteti të pavarur. (Hajrullah Koliqi)

HISTORIA E LETËRSISË. Historia e letërsisë është pamje e trajtimit të letërsisë në rrjedhë të kohës. Çështja shtrohet për mënyrat e metodat e shkrimit të saj, duke pasur në ndihmë teorinë e letërsisë e kritikën letrare, tekstin e kontekstin letrar. Histori e epokave apo formacioneve letrare; histori e gjinive apo ligjëtimeve letrare; histori e formave apo e letërsisë si dokument e si monument, histori e përhershmerive apo e transformimeve, madje histori si përmbledhje shqyrtimeve kritike.

Historitë e letërsive kombëtare ndërfitin kritere specifike të përshkrimit të zhvillimit të tyre. Prova e projekte të shkrimit të historisë së letërsisë shqipe kanë bërë autorë shqiptarë e autorë të huaj, duke shkruar tekste të nivelit shkollor apo të nivelit akademik. Alberto Straticò në veprën "Manuale di letteratura albanese" (1896) trajton letërsinë gojore, autorë të hershëm shqiptarë dhe autorë arbëreshë, por nuk trajton autorë shqiptarë të shekullit XIX. Justin Rrota (1889-1964) në tekstin "Historija e letraturës shqipe" (1925), me cilësimin "Mbi shkrimtarë më në shëj të gjuhës shqipe", në 26 paragrafë rreshton shkrimtarët nga Gjon Buzuku deri te Fan Noli. Gaetano Petrotta (1882-1952) në librin "Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare" (1932) me cilësimin "letërsia e kultivuar" trajton kronologjikisht autorët nga Muhamet Çami deri te Dhimitër Pasko. Eqrem Çabej (1908-1980) në librin "Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe" (1936), në kapitullin "Literatura", në 31 njësi trajton autorët shqiptarë nga Gjon Buzuku deri te Dhimitër Pasko, duke dhënë tekste të zgjedhura. Ernest Koliqi (1903-1975) e Namik Resuli (1908-1985) redaktorë në veprën "Shkrimtarë shqiptarë I, II" (1941-1942) trajtojnë letërsinë shqipe deri te Millosh Gjergj Nikolla, duke dhënë tekste të zgjedhura të tyre. Stuart E. Mann (1905-1986) "Albanian literature: An Outline of Prose, Poetry, and Drama" (1955) krijon një pasqyrë të letërsisë shqipe në përgjithësi. Giuseppe Schirò (1905-1984) në "Storia della letteratura albanese" (1959) në pjesën e parë trajton letërsinë popullore shqipe, kurse në pesë pjesë të tjera autorët të vendosur në epoka letrare, duke nisur nga Gjon Buzuku deri tek autorët bashkëkohës në Shqipëri e në Kosovë. Skiroi portretion shkrimtarët, interpreton veprat dhe sistematizon hartën letrare në kohë. Arshi Pipa (1920-1997) në studimin "Albanian Literature: Social Perspectives" (1978) sistematizon kërkimin në shtatë kapituj, në fund propozon një sociologji të letërsisë shqipe dhe një periodizim të kësaj letërsie në katër periudha letrare, ndërsa në periudhën e katërt "Letërsia bashkëkohore: 1944-1974" përfshin edhe letërsinë shqiptare në Jugosllavi e shkrimtarët shqiptarë jashtë shtetit. Dhimitër Shuteriqi (1915-2003) (redaktor) në "Historia e letërsisë shqipe" (që nga fillimet deri te Lufta Nacionalçlirimtare) (1983) letërsinë e ndan në tri periudha, porse harta letrare dhe autorët shqyrtohen me një pamje të tepruar

ideologjike, madje duke u përjashtuar disa nga sistemi letrar. Robert Elsie (1950) në veprën “History of Albanian Literature” (1995) në trembëdhjetë kapituj trajton shqiptarët e gjuhën e tyre dhe letërsinë shqipe në Shqipëri, në diasporën shqiptare e në Kosovë, që nga autorët më të vjetër deri te autorët bashkëkohorë. Rexhep Qosja (1936) në veprën “Histori e letërsisë shqipe, Romantizmi I, II, III” (1985-1986) bën studimin e letërsisë romantike si poetikë e si vështrim mbi autorë e vepra dhe propozon një periodizim të letërsisë shqipe. Ibrahim Rugova (1944) në studimin historik e teorik “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare (1504-1983)” (1986) periodizimin e kësaj kritike e bën me kriterë kronologjike e sociokulturore. Sabri Hamiti me serinë e kërkimeve “Sprova për një poetikë”, duke interpretuar e kanonizuar, propozon një histori të poetikës shqipe. (Sabri Hamiti)

HJEKËSIA. Veprim që lidhet me ndërhyrje ndërmjet palëve të hasmuara, misioni i kundërt me pajtimin dhe dorëzimin. Pra, bëhet fjalë për veprimtarinë e ndërhyrjes ndërmjet dy palëve të gjakësuara, por që nuk është as “shtysi”, as “ndihmëqari”, nocione që lidhen me veprime specifike, sidomos në Kosovë. Personat në rolin e hjekësve, me qëllim dhe vetëdije të plotë, janë angazhuar për të siguruar kanale të fshehta dhe qasje të ndjekësve, për ta kryer gjakmarrjen mbi dorasin apo të afërmit e tij të ngjuar. Këta persona ndërmjetës dhe ndërlidhës zakonisht janë cilësuar si dashamirës dhe të afërt të familjes së dëmtuar, që synonte kryerjen e gjakmarrjes, apo si armiq të familjes që e strehonte gjakësin. Me kohë fenomeni ka marrë përmasa që përfshinte edhe personat që për këtë shërbim kërkonin shpërblime. Për këtë arsye në popull është cilësuar dhe vlerësuar si veprim i rrezikshëm dhe moralisht i ulët, andaj është dashur të kryhet në fshehtësi të plotë. Kujtesa popullore ka ruajtur raste që në këtë rol të jenë gjendur edhe gratë, qofshin ato të martuara në familjet që i strehonin dorasit apo familjarët e tyre, qofshin bija të atyre familjeve. Nëse një veprim i atillë dëshmohej me prova, e drejta zakonore këtë e konsideronte si vepër të “prerjes së mikut në shtëpi” dhe nuk ofronte ndonjë alternativë tjetër, përveç vrasjes së hjekësit ose hjekëses. Gjaku i gruas hjekëse shkonte “hups”, që do të thotë se gjinia e saj privohej nga e drejta kanunore dhe morale që

të kërkonte hakmarrje të arsyeshme për bijën e tyre të vranë për veprim hjekësie. (Anton K. Berishaj)

HOGOSHTI. Fshat në komunën e Kamenicës, rreth 7 km në verilindje nga qendra. Shtrihet në të dy anët e lumit Hogosht, me sipërfaqe 15.5 km², numri i banorëve 1,705 dendësi e banimit 110 b/km². Si vendbanim përmendet në disa dokumente të shkruara. Në sallamanet e vilajetit të Kosovës (1893) është i regjistruar me emrin Hogoshta. Në vitin 1905 Hogoshti kishte 100 shtëpi shqiptare. Sipas regjistrimit të fundit (2011) ka 1,705 banorë, ndaj 1,620 banorëve sa kishte në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi, ndërsa një numër i konsiderueshëm i familjeve jetojnë nga remitancat e punëtorëve me punë të përkohshme në botën e jashtme. Është seli e bashkësisë lokale, në të cilën gravitojnë 15 fshatra. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore dhe gjimnazin, qendrën e mjekësisë familjare, postën, shtëpinë e kulturës, disa biznese tregtare dhe zejtare etj. (Shpend Agaj)

HOLLBRUK Riçard (Richard Holbrooke) (1941-2010). Diplomati amerikan, gazetar. Lindi në Nju-Jork. Studioi historinë, politikën ndërkombëtare dhe gjuhën gjermane. Në peri-



RIÇARD HOLLBRUK

udhën 1962-1966 ishte i angazhuar në Vietnam, si përfaqësues rajonal i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe më vonë në ambasadën amerikane në Saigon. Në vitin 1966 Hollbruk hyri në shtabin e Shtëpisë së Bardhë gjatë mandatit të Presidentit Lindon Xhonsn, më pas ishte botues i revistës “Foreign Policy” dhe njëri nga botuesit e revistës “Newsweek”. U bë i njohur në vitet ‘90 të shekullit të kaluar, si i dërguari i posaçëm i SHBA-së për Ballkanin dhe konsiderohet si arkitekti i Marrëveshjes së Dejtonit, e cila i dha fund luftës në Bosnjë e Hercegovinë. Në periudhën e luftës në Kosovë 1998/1999, ishte i dërguar i posaçëm i SHBA-së. Në tetor të viti 1998 arriti një marrëveshje me Millosheviqin, e cila parashihte lejimin e vendosjes së Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë. Gjatë Konferencës së Rambujesë, me nxitjen e sekretares

Medlin Olbrajt (Madeliene Albright), ai u angazhua sërish për të ndikuar te Beogradi që të pranonte Marrëveshjen e Rambujesë. Në periudhën 1999-2001 ishte ambasador i SHBA-së në OKB, ndërsa më 2009 mori detyrën e të ngarkuarit të posaçëm për Pakistanin dhe Afganistanin. (Valdrin Ukshini)

HONDOZI Faik (1981-). Tenor. Lindi në Prishtinë. Pas Shkollës së mesme të muzikës në Prishtinë (2000), kreu Akademinë e Arteve në Tiranë (2004) dhe më pas u specializua në Teatrin e Operës dhe Baletit (TOB) po në Tiranë. Specializimin në teknikën vokale e kreu në Konservatorin e Vjenës (2006-2009) dhe më pas në Itali (2009-2014). Në periudhën 2004-2006 u prezantua me rolet: Princi i Persisë dhe Perandori në operën "Turandot" e Gj. Puçinit, Nemorino në operën "L'elisir d'amore" e G. Donizetit në TOB në Tiranë dhe me Luftëtarin në operën "Vjeshtë me stuhi" e Dh. Lekës. Në periudhën 2007-2011 u paraqit në skenë me Dukën në operën "Rigoletto" të Gj. Verdit, si dhe në teatrot e operës dhe baletit në Vjenë, Salzburg, Graz dhe Linz. Më 2011 ishte finalist në Konkursin ndërkombëtar "Luciano Neroni" dhe "Benvenuto Franci" dhe më 2012-2013 solist i ansamblit "Ronacher Theater". Nga viti 2012 është solist në "Wiener Residenz Orchester". Më 2015 ishte pjesëmarrës në koncertin "Tre tenorët" në Tiranë dhe më pas në dy produksione operistike në Vjenë, ku këndoi rolin e Ferrandos nga opera "Cosi fan tutte" të Mozartit, si dhe të Rudolfos në operën "La Boheme" të Gj. Puçinit. (Besa Luzha)

HONIATI Nikita (1155-1215/1217). Historian, teolog dhe nëpunës i lartë bizantin. Lindi në qytetin e vjetër Konae të Frigjisë (sot në Turqi). U arsimua në Konstandinopojë. Ishte administrator në oborrin e perandorëve Aleksi I Komnen (1081-1118) dhe Manueli I Komnen (1143-1180) e më pas qeveritar i temës së Filipopolit (Plovdivit në Bullgari). Në vitin 1204 u bë senator në Konstandinopojë, më pas u arratis në Nike, ku punoi këshilltar në oborrin e perandorit Teodor Laskar dhe përfundoi historinë e tij me titull "Koha e rrëfimeve" në 21 vëllime. Në këtë vepër flitet për historinë e Perandorisë Bizantinë midis viteve 1118-1206. Vepra përbën burimin më të rëndësishëm të kohës dhe e radhit autorin ndër historianët më të mirë bizantinë. Ajo jep informacione edhe

për historinë e Arbërisë, si, bie fjala, për pushimet e përkohshme të Prizrenit, Nishit, Shkupit dhe Leshakut në Pollogun e Poshtëm nga zhupani i Rashës, Nemanja, në vitet 1189-1190. Nikita shkroi edhe një antologji dokumentesh teologjike dhe fjalime të perandorëve bizantinë. (Ramiz Abdylly)

HOPF Karl (1832-1873). Historian dhe bizantolog gjerman. Lindi në qytetin Hamm të Vestsfalisë (Gjermani). Studioi në Bon, ku u diplomua dhe u doktorua në historinë mesjetare të Greqisë. Më 1853 kishte ndërmarrë një studim hulumtues nëpër biblioteka dhe arkiva të Italisë, ndërsa më 1858 u zgjodh profesor bibliotekar në Grieswald dhe më pas në Universitetin e Konigsbergut. Vepra e tij më e njohur mbetet "Historia e Greqisë nga fillimi i mesjetës deri në vitin 1821". Ch. Hopf u bë i njohur në historiografinë shqiptare për zbulimin dhe publikimin e "Memories" të Gjon Muzakës të shkruar më 1510 dhe pas vdekjes së tij, e plotësuar nga Konstandini, njëri nga bijtë e tij. Dokumenti, që është një manuskript i shkruar në pergamenë, u zbulua nga Ch. Hopf në vitin 1863. Hopf e bëri të njohur zbulimin e tij një vit më vonë, duke vënë në dukje rëndësinë e zbulimit. Dhjetë vjet më vonë, më 1873, Hopf publikoi dorëshkrimin e plotë në veprën "Kronikat greko-romane". (Muhamet Mala)

HORVAT Branko (1928-). Ekonomist kroat, profesor universiteti. Lindi më 1928 në Petrinje (Kroaci). Shkollën fillore e të mesme i kreu në Pozhegë. Si 16 vjeçar iu bashkua partizanëve.



BRANKO HORVAT

Kreu Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Zagrebit dhe doktoroi po për ekonomi në Universitetin e Mançesterit në Britani të Madhe. Ishte profesor i rregullt në Universitetin e Zagrebit dhe të Beogradit dhe mbajti ligjërata në shumë universitete dhe institute të njohura në Europë dhe në SHBA. Veprimtaria shkencore dhe publicistike e B. Horvatit përfshin shumë libra, monografi dhe shkrime të tjera nga lëmi i ekonomisë, politikës, sociologjisë, filozofisë dhe fusha të tjera. Në vitin 1988 në Lubjanë botoi librin "Çështja e Kosovës", pjesa më e madhe e të cilit i kushtohet historisë së

Kosovës, Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Përmes këtij libri B. Horvat bëri të njohur në opinionin jugosllav një vështrim më realist dhe të paanshëm të problemit kosovar, duke vlerësuar drejt një sërë çështjesh që lidheshin me statusin e Kosovës dhe me zhvillimet rreth saj në ish-Jugosllavi. (Adem Murati).

HORREA. Hambarë apo magazina ku deponohej drithi në qytetet romake. Shërbente gjithashtu për ruajtjen e frutave, verërave dhe mallrave në përgjithësi. Objekte të tilla janë zbuluar edhe në territorin e Kosovës, në qytetet romake të Ulpianës, në Municipium DD dhe në Gradinë të Pejës. (Arben Hajdari)

HOTEL “DUKAGJINI”, PEJË (Arkitektura). Ish-hotel “Metohija” u ndërtua në vitin 1956. Projektin e hartoi arkitekti Vladislavleviq nga Beogradi. Në vitin 1975 hotelit iu bë një



HOTEL “DUKAGJINI”, PEJË

rikonstruktiv tërësor dhe i thellësishëm, përfshirë edhe riorganizimin funksional në tërësinë e hapësirës së tij. Pas kësaj ndërhyrjeje hoteli krijoi një tërësi të re të suksesshme arkitekturore. Projektin për rivitalizimin e hotelit e kanë hartuar vëllezërit Qemajl dhe Agush Beqiri (Nallbani), të ndihmuar edhe nga Matej Rodiqi si dizajner. Pas luftës hoteli u riemërua zyrtarisht si Hotel “Dukagjini”. Pas vitit 2010 në hapësirën dhe tërësinë e hotelit u bënë ndërhyrje të tjera, e cila ia humbi objektit tërësisht fizionominë arkitekturore të krijuar nga restaurimi i parë. (Dervish Qerreti).

HOTELERIA. Pjesë e sektorit të turizmit, e cila përfshin një varg aktiviteteve shërbyese dhe prodhuese, në radhë të parë shërbimet e akomodimit dhe të ushqimit. Shërbimet hoteliere janë duke u zgjeruar në vazhdimësi, si për nga struktura dhe forma, ashtu edhe për nga funksioni dhe produktet me ndikime të ndjeshme ekonomike. Koncepti i hotelierisë është zgjeruar në industri të hotelierisë, përkatësisht në “industri të mikpritjes”, duke vënë theksin te qëndrimi miqësor i mikpritësit ndaj vizitorit ose turistit. Hoteliera të ne nuk ka pasur vazhdimësi zhvillimi dhe ajo ka kaluar nëpër disa faza. Faza e parë përfshin periudhën nga fundi i viteve ‘60 deri në fund të viteve të ‘70 të shekullit të kaluar, e cila karakterizohet me nivel të ulët të zhvillimit. Faza e dytë përfshin fundin e viteve ‘70 deri në mesin e viteve ‘80, e cila karakterizohet me ndërtimin e hoteleve në qendrat kryesore urbane dhe në Brezovicë. Faza e tretë përfshin fundin e viteve ‘80 deri në fund të luftës së fundit në Kosovë, e cila karakterizohet me ngecjen dhe degradimin e sistemit ekonomik në përgjithësi dhe të hotelierisë në këtë kuadër, por edhe me një zhvillim relativisht dinamik të hotelierisë private, të pakontrolluar dhe të përqendruar në zonat urbane dhe përgjatë rrugëve kryesore. Faza e katërt përfshin periudhën pas vitit 2000, e cila karakterizohet me ngritjen e strukturave hoteliere të standardeve më të larta, siç janë hotelet urbane me 4 dhe 5 yje, si dhe shënon fillimin e ngritjes së strukturave të para hoteliere në rajonet malore të Sharrit dhe të Alpeve Shqiptare në territorin e Kosovës. (Zekë Çeku)

HOTELI “GRAND”, PRISHTINË (Arkitektura). Hotel i kategorisë “A” në qendër të Prishtinës, i ndërtuar në vitin 1978. Projektin e parë investues-technik i hotelit me kapacitet prej 300 shtretër si dhe ndërtimi i projektit, me qëllim të rritjes së kapacitetit dhe numrit të shtretërve në 600, është përgatitur në korrik të vitit 1972 nga byroja projektuese “Invest Byro” nga Beogradi, me projektuesit kryesorë B. Fehmiu, D. Kovaçević dhe M. Jevremović, mbështetur në planin detal të “Sheshit të Republikës” në Prishtinë. Punëkryesi kryesor ishte kombinati ndërtimor “Ramiz Sadiku” nga Prishtina, ndërsa në ndërtimin e tij morën pjesë edhe rreth 30 ndërmarrje nga mbarë ish-Jugosllavia. Punët e ndërtimit filluan në vitin 1973 dhe përfunduan në vitin 1978. Hoteli



HOTELI "GRAND", PRISHTINË

"Grand" ishte ndërtesa më moderne gjatë viteve '70-'80 të shekullit të kaluar në Prishtinë, me një sipërfaqe rreth 30 mijë metra katrorë bruto, e përbërë nga tri kulla me kate të ndryshme, "A" me 6 kate, "B" me 12 kate dhe "C" me 8 kate, 2 meskate të shtrirë në tërë sipërfaqen, përdhese, kate teknike në mes të katit të parë dhe të dytë si dhe të kopshtit dimëror, i cili me kërkesë të investitorit të parë "Sloga" u shndërrua në restorant. Hoteli u ndërtua me kapacitet prej 500 dhomash me 600 shtretër, me 2 salla për bankete, një sallë për mbledhje me 200 ulëse, si dhe hapësira përcjellëse për nevoja hoteliere të standardit të lartë për kohën. Adaptimi i parë është bërë në vitin 1986. Ndërtesa ka strukturë të qartë dhe vëllime të organizuara mirë. Në vitin 2006 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpalli tenderin për privatizimin e Hotelit "Grand", proces që nuk ka përfunduar ende. (Vlora Navakazi)

HOTELI "SWISS DIAMOND", PRISHTINË (Arkitektura). Ndërtesë e hotelit të Prishtinës, e ndërtuar në vitet '60 të shekullit të kaluar, i cili më vonë mori emrin hoteli "Bozhur". Në vitin 1955 punohet projekti ideor për hotelin e qytetit të kategorisë "A" nga byroja projektuese e KPK-së, Prishtinë, kurse projekti kryesor nga byroja projektuese "Turistprojekt" nga Beogradi. Godina u ndërtua në stilin monumental të viteve '60, me sipërfaqe rreth 2,400 m², etazhitet B+P+4, me kapacitet 130 shtretër. Për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve, në vitin 1964 filloi ndër-



HOTELI "SWISS DIAMOND", PRISHTINË

timi i aneksit/depadansit të hotelit ekzistues, me kapacitet të shtuar prej 100 shtretër, të organizuar në dhoma njëshe dhe dyshe. Hoteli i qytetit, për nga komoditeti, kategorizohet në nivel me hotelet e kohës: në katin përdhese kishte restorant dhe kafene me tarracë të madhe të vizituar prej qytetarëve dhe vizitorëve të shumtë. Pas vitit 1999, ish-hotel "Bozhuri" emërohet në hotel "Iliria", emër që e mban deri në vitin 2006, kur privatizohet nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Po atë vit kompania "Mabetex" në Prishtinë punoi projektin dhe filloi rindërtimin e hotelit. Në vitin 2010 përfundojnë punimet e rindërtimit të hotelit me strukturë dhe pamje të re, vëllim qendror me etazhitet 3B+P+7, ambiente të përshtatshme dhe funksionale për mysafirë dhe emër të ri, "Swiss Diamond Prishtina". (Vlora Navakazi)

HOTI Afrim (1975-). Politikolog, mësimdhënës universiteti. Lindi në Ratkoc të komunës së Rahovecit. Shkollimin fillor e mbaroi në Ratkoc, kurse atë të mesëm në Rahovec dhe Prizren. Kreu Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës (UP), studimet master në Sarajevë dhe Bolonjë, në programin europian për demokratizim dhe të drejta të njeriut në Europën Juglindore. U doktorua për shkencë politike në Universitetin e Hamburgut dhe atë të Sofjes. Më 2004 filloi punë në UP si asistent në departamentin e shkencave politike. Më vonë ligjëroi lëndë nga fushat e së drejtës ndërkombëtare, organizatave ndërkombëtare

dhe mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ka bërë një numër vizitash studimore dhe specializimesh profesionale në disa vende europiane. Është bashkautor i librit “Panimi i vetëvendosjes dhe evoluimi i tij në të drejtën ndërkombëtare” dhe i një numri artikujsh shkencorë dhe profesionalë nga lëmi i së drejtës dhe i shkencës politike. Ushtrroi funksione të ndryshme në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. (Alfred Marleku)

HOTI Behram (1945-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Likoc të Skënderajt. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën Normale në Prishtinë dhe në Mitrovicë, kurse studimet universitare dhe pasuniversitare, dega gjuhë dhe letërsi shqipe, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në shkolla fillore e të mesme. Nga viti 1974 punoi në Prishtinë, derisa u pensionua. Filloi të botonte vjersha për fëmijë që nga viti 1958. Më pas botoi vjersha dhe tregime për fëmijë si dhe vjersha, tregime, novela, romane, kronika, monografi dhe shkrime publicistike, ndër të cilat do veçuar librin me tregime “Pantomimë” (1983), librin me poezi “Mos ma mbyll derën” (1992), romanin “Doktori i Anamalësisë” (1995), kronikën “Anton Çetta orakulli i pajtimit” (1996) etj. (Hasan Hasani)

HOTI Beqir (1937-). Gazetar. Lindi në Mamuras (Shqipëri). Në vitin 1941 familja e tij u shpërngul në Pejë, ku ai kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën normale e përfundoi në Prishtinë. Disa vjet punoi mësues në fshatrat Raushiq dhe Glllogjan dhe më pas në Pejë. Në vitin 1960 bëhet korrespondent nga Peja i gazetës “Rilindja”. Përfundoi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1973). Ndërkohë u zgjodh sekretar i Komitetit Komunal të LK në Pejë, detyrë që e ushtroi deri më 1981, kur u zgjodh sekretar ekzekutiv në Kryesinë e Komitetit Krahinor. Nga viti 1986 deri më 1990 ishte kryeredaktor i gazetës “Rilindja”. Me suprimimin e autonomisë së Kosovës më 1990 largohet nga pozita e kryeredaktorit të “Rilindjes” dhe u kthye në Pejë, si i pensionuar i parakohshëm. (Nehat Islami)

HOTI Demë (1952-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Junik, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në



DEMË HOTI

Shkollën Normale të Gjakovës, ndërsa studimet themelore dhe ato të magjistraturës për pedagogji i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku edhe u doktorua. Në vitin 1980 u zgjodh asistent, pastaj mësimdhënës në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, ku mbajti mësim nga metodika, andragogjia, metodologjia e mësimdhënies etj. dhe i arriti të gjithë titujt universitarë. U angazhua edhe në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë etj. Mori pjesë në shumë konferenca shkencore, vizita studimore, trajnime, seminare profesionale etj. në Kosovë dhe jashtë. Është bashkautor teksteve shkollërore, si dhe i tekstit universitar “Të drejtat e fëmijëve dhe etika e mësimdhënies” (2006), i një doracaku për edukatorë dhe prindër dhe i monografisë “35 vjetori i Universitetit të Prishtinës” (2008). (Afërdita Deva-Zuna)

HOTI Fahredin (1953-1999). Mjek, gjinekolog-obstetër, dëshmor. Lindi në Krushë të Madhe. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme të mjekësisë në Prizren, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë e nisi në Sarajevë dhe e përfundoi në Prishtinë (1983). Një kohë të gjatë punoi si mjek i përgjithshëm në Rahovec. Në vitin 1991 kreu specializimin për gjinekologji me obstetrikë në Rijekë të Kroacisë. Gjatë viteve '90, pas përjashtimit nga puna, u angazhua në punë humanitare. Punoi edhe si mësimdhënës në shkollën e mesme të mjekësisë “Dr.L.Motroni” në Prizren. Gjatë periudhës së luftës bëri punën e pediatrit, kirurgut, internistit e edhe të teknikut mjekësor, duke filluar nga Krusha e Madhe, Açaeva, Likoci, Drenoci dhe në shumë vendbanime të tjera të Rahovecit e të Malishevës. Më 26 mars 1999, bashkë me djalin e tij 17-vjeçar, u pushkatua nga forcat serbe. (Selami Sylejmani)

HOTI Haxhi (1967-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor i kombit. Lindi në Rogovë të Gjakovës. Deri në vitin 1997 jetoi në Zvicër dhe më pas u kthye në Kosovë. Në mars të vitit 1998 vuri kontaktet e para me pjesëtarët e UÇK-së. U

emërua koordinator për të themeluar njësitë e para ushtarake në fshatrat e Hasit. Në fillim veprimtaria e këtyre njësiteve ishte mbështetja logjistike për ushtarët e UÇK-së, të cilët kalonin nëpër fshatrat e Hasit për në Shqipëri, për t'u furnizuar me armatim. Më 8 qershor 1998, duke udhëhequr një kolonë të pjesëtarëve të UÇK-së në kthim për në Kosovë, u vra në luftë me forcat ushtarake serbe në malet e Pashtrikut. (Bedri Muhadri)

HOTI Izber (1948-). Historian. Lindi në fshatin Revuç të Podujevës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë, studimet për histori në Universitetin e Prishtinës (1975). Po aty kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës më 1982. Nga viti 1975 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë. Është autor i dhjetëra monografive shkencore: "Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë" (1986), "Lëvizja ilegale antifashiste në Kosovën Lindore 1941-1944" (1990), "Çështja e Kosovës gjatë luftës së Dytë Botërore" (1997), "Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve 1930-1941" (1997), "Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore" (1998), "Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë 1941-1945" (1999), "Zhvillimi i mendimit historik dhe i historiografisë" (1994), "Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare" (2004) etj. Ka botuar edhe një sërë kontributeve teorike-metodologjike në revistat shkencore të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Kroacisë etj. Gjithashtu ka marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara në Kosovë, në vende të ndryshme të Europës dhe në SHBA. (Haki Kasumi).

HOTI Rexhep (1964-). Gazetar. Lindi në Krushë të Madhe të Rahovecit. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës, ndërsa disertacionin e doktoratës për shkencë politike e mbrojti në Tiranë. Si student nxori gazetën "Fundamenti", botim i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Në fillim të viteve '90 u vendos në Lubjanë, ku punoi si lektor i revistës "Alternativa" e më pas edhe redaktor i revistës "Demokracia autentike" (DEA). Pas luftës në Kosovë kreu detyra të ndryshme në institucionet e vendit: këshilltar politik i kryeministrit, koordinator i Zyrës Ndërlidhëse

Qeveri e Kosovës-UNMIK, deputet i Kuvendit të Kosovës etj. Më pas themeloi gazetën e përditshme "Infopress", "Tribuna shqiptare", "Sport", revistën "IP-magazinë" dhe së fundi televizionin "Tribuna Chanel" dhe gazetën "Tribuna". Është autor i librave letrarë dhe publicistikë: "Tempulli i fjalës" (2002), "Nata e Kosovës" (2003), "Kosova përballë vetvetes" (2004), "Pesha e konsensusit" (2006) etj. (Artan Krasniqi)

HOTI Shaqir (1936-). Instrumentist popullor, krijues dhe përpunues i veglave aerofone. Lindi në fshatin Rogovë të Hasit. Që në moshën 6-vjeçare luajti me instrumentet aerofone si fyej, kavallë, bishtnica, pipëza etj. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen e muzikës në Prizren, në flaut. Një kohë punoi në fshatin e lindjes, duke kontribuar në organizimin e jetës kulturore. Më pas u angazhua në orkestrën



SHAQIR HOTI

popullore të Radio Prishtinës si flautisti i parë. Mori pjesë në festivale me karakter vendor dhe ndërkombëtar me instrumente frymore. Mbetet e veçantë paraqitja në Berlinin Perëndimor më 1969, në një festival ndërkombëtar, ku me këngën "Baresha" të R. Mulliqit, të interpretuar nga Nexhmije Pagarusha, fituan çmimin e parë. Sot ka një punëtori dhe galeri instrumentesh aerofone mej rreth 2,000 instrumentesh. (Krenar Doli)

HOTI Ukshin (1943-1999). Politolog, profesor universiteti, politikan. Lindi në Krushë të Madhe komuna e Rahovecit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën normale e kreu në Prizren dhe në Prishtinë. Studimet për shkencë politike i kreu në Universitetin e Zagrebit, ndërsa studimet pasuniversitare i mbaroi në Beograd, për marrëdhënie politike dhe ekonomike ndërkombëtare. Nga viti 1972 deri më 1978 ishte sekretar për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Këshillin Ekzekutiv të KSA të Kosovës. Pas dorëheqjes nga ky post, vazhdoi



UKSHIN HOTI

specializimet në disa universitete, si në Harvard, Çikago, Kembrixh dhe Uashington. Botoi punime shkencore dhe libra nga kjo fushë, si “Lufta e ftohtë dhe detanti” (1975) dhe “Filozofia politike e çështjes shqiptare” (1995). Që nga fillimi i viteve ‘70 e deri me burgosjen e tij më 1981 ushtroi funksione të ndryshme politike dhe arsimore. Ishte anëtar i të gjitha forumeve federale të ish-Jugosllavisë, që atëbotë merreshin me politikë ndërkombëtare. Ishte i pari që vuri themelet e marrëdhënieve diplomatike të Kosovës me SHBA-në, me Shqipërinë e me vendet e tjera perëndimore. Në vitin 1981 mbrojti dhe e arsyetoi kërkesën për Republikën e Kosovës dhe përkrahu demonstratat studentore, për çka u burgos dhe u dënua me 9 vjet burgim. Pas liritimit më 1985, regjimi serb e mbajti të izoluar plotësisht në vendlindjen e tij. Në vitin 1990 shkoi në Lubjanë, ku punoi në revistën “Alternativa” dhe “Republika”. Më pas nxori dhe drejtoi revistën “Demokracia Autentike-DEA”. Pasi u kthye në Kosovë, vazhdoi të punojë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në mars të vitit 1993 u burgos për herë të dytë, pas organizimit të homazhit për martirët e demokracisë në Brestovc të Rahovecit. Në të njëjtin vit u rrah brutalisht nga forcat speciale serbe, pasi kishte vizituar pjesëmarrësit e grevës së urisë në pallatin e shtypit “Rilindja” në Prishtinë. I pakënaqur me zhvillimet politike në Kosovë, në vitin 1993 braktisi Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe mori kryesinë e Partisë së Unitetit Kombëtar, kurse më 17 mars 1994 u arrestua për herë të tretë dhe u dënua me 5 vjet burg. Më 16 maj 1999, një ditë para se të përfundonte vuajtjen e dënimit, udhëheqja e Burgut të Dubravës e nxori jashtë objektit të burgut dhe prej atëherë u zhdruk pa gjurmë. (Osman Ismaili.).

HOTLA Sylë (Sulejman Asip Sulejmani) (1875-1947). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste. Lindi në Kumanovë. Aktivitetin e tij ushtarak e politik e fillon gjatë luftës së Parë Botërore (1916). Në kohën e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene bie në konflikt me regjimin serb dhe arratiset në mal. Më pas kapet dhe burgoset nga regjimi serb. Nga viti 1927-1941 ishte kryetar i komunës së Mateçit. Pas pushtimit bullgar (1941) emërohet udhëheqës i të ashtuquajturës “Kontraçetë”. Pas kapitullimit të Bullgarisë organizon çetat vullnetare nacionaliste shqiptare, duke luftuar për mbrojtjen

e popullatës civile nga depërtimi i njësiteve partizane. Bashkëpunon me forcat e ushtrisë kombëtare të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Caktohet komandat i çetave të Ballit Kombëtar për viset e Kumanovës. Në tubimin e Mateçit dhe të Tetovës, në shtator 1944 zgjidhet komandat i forcave ushtarake për viset e Karadakut. Në shtator-nëntor 1944 u prin forcave nacionaliste shqiptare në rrethin e Kumanovës. Gjatë kësaj kohe bashkëpunoi edhe me forcat nacionaliste në Preshevë. Më 17 dhjetor 1944 në kuvendin themelues të shtabit drejtues të Rezistencës Shqiptare për Kosovën Lindore zgjidhet komandant i njësisë guerile. Merr pjesë në formimin e Komitetit të NDSH-së për Kumanovë (1945). Pas Kuvendit të Dërvenit (prill 1945), aktiviteti i tij vështirësohet. Merr pjesë në Kuvendin e Kopilaçës mbi Tanushë më 15-16 gusht 1945, ku u bë përpjekje për riorganizimin e luftës së çetave nacionaliste vullnetare shqiptare. U ekzekutua më 11 tetor 1947 në Shkup. (Irir Zylfiu)

HOXHA Abdullah (1853-1910). Luftëtar dhe organizator i lëvizjes për liri dhe pavarësi kombëtare. Lindi në fshatin Kovaç të Gashit në Malësinë e Gjakovës. Pas përfundimit të Medresesë në Gjakovë punoi si hoxhë, por gjatë gjithë jetës luftoi dhe udhëhoqi beteja për liri e pavarësi. Në shtator të vitit 1878 ishte pjesëmarrës në aksionin e organizuar kundër Mehmet Ali Pashë Maxharrit, ndërsa në vitet 1879-1880 luftoi për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë. Më 1881 mori pjesë në luftimet për çlirimin e Shkupit, si dhe në betejet e Shtimes dhe Slivovës. Në vitin 1899 ishte pjesëmarrës në Lidhjen e Pejës. Ishte pjesëmarrës aktiv në kryengritjet e viteve 1909-1910 kundër forcave të Xhavit Pashës dhe atyre të Shefqet Turgut Pashës. U shqua, sidomos, në luftimet në Qafë të Morinës, nën udhëheqjen e Bajram Currit. Ishte pjesëmarrës në tubimin e Verrave të Llukës (prill, 1910) për pajtimin e gjaqeve dhe bashkimin në luftë kundër forcave osmane. Pasi u kap nga forcat turke, u var në Gjakovë më 27.11.1910. (Islam Lauka)

HOXHA Abit (1982-). Gazetar, studiues i medias. Lindi në Skënderaj. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për shkenca politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare për gazetari dhe komunikim

në Prishtinë dhe në fushën e sigurisë në Universitetin e Durhamit në Britaninë e Madhe. Ka botuar disa punime shkencore në fushën e gazetarisë, të sigurisë dhe të politikës së jashtme. Është autor i librit “Raportimi në Kosovë: lufta dhe paslufta” (2010), në të cilin trajton disa tematika të raportimit në Kosovë dhe rreth Kosovës. Më pas vijoi studimet e doktoratës në Universitetin Ludwig Maximilian në Muni të Gjermanisë. (Ibrahim Berisha)

HOXHA Avdyl (1870-1945). Veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi në Junik. Ishte pjesëmarrës aktiv në organizimin e kryengritjeve 1908-1912. Ishte njëri ndër organizatorët për përgatitjen e Kuvendit të Junikut më 21-25 maj të vitit 1912. Gjatë luftërave ballkanike luftoi në Qafë të Bogiqës për të mbrojtur Plavën dhe Gucinë nga forcat malazeze. Një kohë ishte kryetar i Zonës Neutrale të Junikut 1921-1923. Përfaqësoi Odën e Junikut. Duke zbatuar ligjet kanunore në Odën e Junikut ndau drejtësi, duke pajtuar gjaqe e ngatërresa. Ishte edhe udhëheqës i këshillit të pleqve. Juniku kishte edhe parinë që zgjidhej nga popullata e saj. Aktiviteti i Parisë së Junikut u dallua gjatë Luftës së Dytë Botërore, posaçërisht në muajt tetor-nëntor të vitit 1944, që njihet si Ngujimi i Junikut. Në janar të vitit 1945, kur filloi likuidimi fizik i anëtarëve të parisë së Junikut, u vra edhe Avdyl Hoxha. (Luan Tetaj)

HOXHA Ballsor (1975-). Shkrimtar, publicist. Lindi në Prishtinë. Shkollimin dhe studimet për gjuhë angleze i kreu në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor në Radiotelevizionin e Kosovës. Më parë ishte i angazhuar në një sërë projektesh ndërkombëtare, me fokus në fushat sociologjike. Në fushën e publicistikës shfaqti interesim për zhvillimet në fushën e kulturës, për fenomenet politike, sociologjike dhe të psikologjisë kolektive në raport me zhvillimet bashkëkohore globale. Botoi librin me poezi “Nirvanë qyteti” (2013), me të cilin u shqua si njëri ndër poetët më avangard të letërsisë së re në Kosovë. Botoi edhe librat me tregime “Bardhëzi” (2014) dhe “Qafëm” (2015), të cilat kanë “ndërtim multistruktural”, me personazhe që kalojnë nëpër situata të paraluftës dhe të pasluftës në Kosovë. B. Hoxha dallohet për prozën e tij karakteristike dhe me teknika narrative që eksplorojnë të renë e panjohur. (Ibrahim Berisha)

HOXHA Din (1892-1961). Veprimtar. Lindi në Kaçanikun e Vjetër. Kreu medresenë në Stamboll. Në periudhën 1935-1941 ishte kryetar i komunës në Kaçanikun e Vjetër. Më 1941 kërkoi që Kaçaniku dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë t'i bashkohen zonës okupuese italiane dhe Shqipërisë Etnike të shpallur prej tyre. Iu kundërvu ushtrisë bullgare dhe organizoi rezistencë të armatosur kundër saj. Largohet nga Kaçaniku dhe u bashkëngjitet forcave vullnetare, ndërsa gruan dhe fëmijët ia burgosin bullgarët. Si komandant i batalionit V, në bashkëpunim me Hysen Tërpezën, Avdyl Durën, Riza Gogën e të tjerë, sulmojnë forcat bullgare dhe ato partizane në Ferizaj, në dhjetor të vitit 1944. Pas dështimit për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve, kalon në ilegalitet dhe i bashkëngjitet Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Merr pjesë në Kuvendin e Kopilaqës (1945). Arrestohet dhe dënohet me 15 vjet burg. Dënimin e vuan në fillim në Kaçanik, mandej në Ferizaj dhe së fundi në Nish. (Daut Bislimi)

HOXHA Edmond (1975-1997). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Junik, ku kreu dhe shkollën e mesme, ndërsa studimet i ndoqi në Fakultetin



EDMOND HOXHA

Juridik në Prishtinë. Ishte aktiv në demonstratat e viteve '90. Ishte ndër të parët që u përfshi në organizimin e fshehtë të UÇK-së. Në fillim bënte pjesë në sektorin e logjistikës në Zonën e Llapit. Në të njëjtën kohë u bë pjesë e njësitit gueril të Prishtinës. Më pas punoi me themeluesit kryesorë të UÇK-së, në Kosovë dhe në Shqipëri. Në fund të janarit të vitit 1997, së bashku me Z. Pajazitin dhe H. Zejnullahun u nisën drejt Vushtrrisë, për të tërhequr armatim për guerilen e UÇK-së. Më 31 janar 1997 në fshatin Pestovë të Vushtrrisë të tre pjesëtarët e UÇK-së ranë në pritë të policisë serbe dhe, pas një ballafaqimi të armatosur, u vranë të tre luftëtarët. Menjëherë pas rënies, emri i E. Hoxhës dhe dy bashkëluftëtarëve të tij u bë simbol i rezistencës së armatosur dhe inspirim për të rinjtë, që t'u bashkohen radhëve të UÇK-së. Pas luftës në Junik, më 27 korrik 2007, në vendin e tij të lindjes, iu ngrit shtatorja në sheshin që mban emrin e tij. Në vitin 2012 nga

presidentja e Kosovës u dekorua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Sabri Simnica)

HOXHA Eliza (1974-). Arkitekte, artiste multimediale. Lindi në Mitrovicë. Kreu Fakultetin e Arkitekturës në Prishtinë (2002), ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin Katolik të



ELIZA HOXHA

Luvenit, Belgjikë (2006). Hapi disa ekspozita personale: “Për ata që s’janë”, multimediale, kushtuar personave të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë, në Galerinë e Arteve të Kosovës në (2007); “Heshtja e këngës”, multimediale

(audio/ video/ performancë/ instalacion), për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, në Muzeu Kombëtar të Kosovës (2014). Mori pjesë në ekspozita kolektive të arkitekturës “Prishtina dje, sot, nesër” (1998), pastaj në Galerinë e Arteve të Kosovës me projektin “Ne” (2003), në vitin 2009 me projektin “Himni im”, kushtuar njëvjetorit të pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu mori pjesë në Bienalen e 53-të të Venecias, në festivalin e artit bashkëkohor në Porto Palermo, pastaj në Shqipëri me projektin “Unë jam” etj. Është fituese e disa çmimeve profesionale dhe mirënjohjeve publike. (Luan Mulliqi)

HOXHA Esat (1942-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollimin bazë e mori në Prishtinë, ndërsa studimet i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës, dega e biologjisë (1964). Një kohë punoi në Shkollën e Mesme të Bujqësisë dhe në Shkollën Normale të Prishtinës. Në vitin 1970 zë punë ligjërues në Shkollën e Lartë Bujqësore të Prishtinës dhe më 1975 pranohet në FSHMN ligjërues për lëndën fitoekologji me fitogjeografi. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN-së të Universitetit të Zagrebit (1976), ndërsa tezën e doktoratës nga lëmi i ekologjisë së bimëve e mbron në FSHMN të Universitetit të Prishtinës (1979). Më pastaj zgjidhet docent për lëndën fitoekologjia me fitogjeografi, pastaj profesor inordinar dhe profesor ordinar (1991). Publikoi punime shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, tekste universitare, tekste për shkolla të mesme etj. Mori pjesë në

konferenca dhe simpoziume shkencore dhe ishte koordinator i disa projekteve shkencore dhe drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe të Ambientit. (Behxhet Mustafa)

HOXHA Fadil (1916-2001). Udhëheqës komunist i Kosovës, komandant i njësiteve partizane dhe bartës i funksioneve shtetërore dhe partiake në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Lindi në



FADIL HOXHA

Gjakovë. Në vitin 1932 për shkollim familja e dërgoi në Shqipëri, së pari në Shkodër dhe më pas në Elbasan, ku kreu Shkollën Normale. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kreu edhe Shkollën e Lartë të Shkencave Politike në Beograd. Para luftës ishte mësues në Gjakovë dhe në fshatin Hogosht të komunës së Kamenicës. Gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri bënte pjesë në grupin komunist të Shkodrës, prej nga që nga vitit 1939 vuri lidhjet me Partinë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ), ndërsa anëtar i PKJ-së u bë në vitin 1941. Me pas u bë njëri nga organizatorët dhe udhëheqësit e luftës së armatosur të aradheve partizane (AP) dhe më vonë edhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) në Kosovë. Deri në mesin e vitit 1942 ishte sekretar i Komitetit të Vendit të PKJ-së për Gjakovë dhe anëtar i Byrosë së Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë, ndërsa që nga kjo kohë qëndroi në Malësinë e Gjakovës (Shqipëri), duke organizuar pika partiake dhe njësitë partizane. Në fund të vitit 1941 u kthye në Kosovë dhe u bë sekretar politik i Aradhes partizane nacionalçlirimtare “Zenel Hajdini”, ndërsa më vonë edhe komandant i saj. Më vonë u bë edhe komandant i Aradhes “Emin Duraku”, si dhe komandant i Shtabit të Përkohshëm dhe Shtabit Suprem të UNÇ-së e AP-së për Kosovë. Në muajin prill të vitit 1943 u caktua komandant i Shtabit Kryesor të UNÇ-së e AP-së për Kosovë, ndërsa nga kjo detyrë u shkarkua në shtator të vitit 1944, kur shtabi kryesor u kthye në shtab operativ. Në fillim të vitit 1945 u emërua zëvendës i komandantit të Administrimit Usharak për Kosovë. Ishte gjeneralmajor në rezervë i Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë. Si njëri nga organizatorët e Konferencës Themeluese të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Kosovës në Bujan të Malësisë së Gjakovës

(Shqipëri), mbështeti Rezolutën e Konferencës, me të cilën popullit të Kosovës i njihej e drejta e vetëvendosjes bashkimit me Shqipërinë, por nuk kundërshtoi letrën e 28 marsit të vitit 1944 të Komiteti Qendror të PKJ-së, me të cilën u kritikua kjo rezolutë, duke u bërë njëkohësisht njëri nga pjesëmarrësit e mbledhjes së dytë të Këshillit Nacionalçlirimtar në Prizren (8, 9 korrik 1945), ku u anulua Rezoluta e Bujanit dhe u vendos që Kosova t'i bashkohej Serbisë. Pas Luftës së Dytë Botërore Fadil Hoxha u bë figura më e rëndësishme politike e Kosovës në hierarkinë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe në institucionet shtetërore në Kosovë dhe në Jugosllavi deri në fund të viteve '80. Ishte kryetar i Kuvendit të Kosovës (1945-1953), kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës (1953-1963), përsëri kryetar i Kuvendit të Kosovës (1967-1969). Ishte gjithashtu anëtar i kryesisë së Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe në vitin 1974, i Kryesisë së Jugosllavisë. Në maj 1978 u zgjodh zëvendëskryetar i Kryesisë së Jugosllavisë me nëntë anëtarë. Ishte Heroi i Popullit dhe bartës i dekoratave të shumta. Me retorikë të ashpër dënoi demonstratat e vitit 1968 dhe 1981 në Kosovë dhe mbajti qëndrim të prerë kundër nacionalistëve shqiptarë të Kosovës. Megjithatë, në atmosferën e krijuar në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 në Serbi dhe në Jugosllavi, qëndrimi dhe puna e tij u vlerësua negativisht nga udhëheqja e komunistëve jugosllavë, u shkarkua nga funksionet dhe më 1991 u përjashtua nga LKJ. Mbështetësit e tij deklaruan se në vitin 1999 përkratu luftën e UÇK-së. La të shkruar ditarin e luftës "Kur pranvera vonohet" dhe librin politik "Jemi në shtëpinë tonë". (Izber Hoti)

HOXHA Fatma (1965-). Gazetare. Lindi në Prishtinë. Në vitin 1969 familja e saj u shpërngul për në Turqi, në Stamboll, ku ajo kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Në vitin 1983 u kthye në Prishtinë dhe një vit më pas nisi punën si gazetare dhe moderatore në Televizionin e Prishtinës, në redaksinë e programit në gjuhën turke. Prej vitit 2000 punon gazetare dhe redaktore në Radiotelevizionin e Kosovës, në redaksinë e programit në gjuhën turke. Raporton edhe për mediet turke, TRT dhe "Istanbul Radyosu". Fitoi disa çmime për punë në gazetari, përfshirë edhe çmimin "Gazetarja e vitit" më 2009. (Hyra Tejeci)

HOXHA Fatmir (1955-). Skulptor, piktor. Lindi në Gjakovë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, në Pejë kreu Shkollën e Mesme të Artit, ndërsa studimet për skulpturë dhe pikturë i kreu në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1978, 1980). Së pari punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme të Prishtinës dhe më pas, në periudhën 1981-1989, ishte bashkëpunëtor profesional në Muzeun e Revolucionit të Kosovës, ndërsa më 1989 u punësua në fabrikën "Metalac" në Janjevë, si drejtor i sektorit për derdhjen artistike në bronz. Nga viti 1999 është mësimdhënës në Fakultetin e Arteve për lëndën e modelimit në drejtimin i skulpturës. Krijimtaria e tij është e njohur me realizimet e skulpturave monumentale të figurave të njohura kombëtare. Ka marrë pjesë në ekspozita kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës. (Agim Rudi)

HOXHA Fehmi (1962-). Dizajner. Lindi në Rahovec. Kreu studimet për dizajn grafik në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1985). Një kohë punoi si menaxher i kulturës në Rahovec (1999-2005), pastaj menaxher i marketingut dhe i komerciales në Fabrikën e Plastikës në Rahovec (2006-2010). Në periudhën 2011-2013 ishte këshilltar politik në Ministrinë e Integritimit Europian dhe këshilltar në Kuvendin Komunal të Rahovecit, ku nga viti 2014 është drejtor i drejtorisë për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit. Mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive dhe hapi disa ekspozita personale në Kosovë dhe jashtë dhe fitoi disa çmime në gara të ndryshme për dizajnimin e logove me rastin e prezantimit në ekspozita të ndryshme (çmimin për etiketë "Minex Ferizaj"; "Qytetar Nderi" në Çaplinë të Bosnjës; "Çmimi i Nëntorit", Gostivar etj.). (Zeni Balazhi)

HOXHA Gani (1933-2018). Gjuhëtar, përkthyes, profesor. Lindi në Kolgecaj të Bajram Currit. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Gjakovë, ndërsa normalen në Prishtinë. Studioi gjuhë dhe letërsi italiane në Beograd, ndërsa studimet pasuniversitare i ndoqi në Zagreb dhe në Firencë. Doktoroi në Prishtinë për huazimet italiane në gjuhën shqipe. Një kohë punoi si redaktor në Radio-Prishtinë dhe nga viti 1974 ligjërues i gjuhës dhe i letërsisë italiane në Universitetin e Prishtinës, ku arriti titullin e profesorit. Botoi

disa libra për mësimin e italishtes si dhe artikuj që lidhen kryesisht me çështje të huazimeve dhe të terminologjisë. Përktheu nga italishtja vepra të Bokaços, Makiavelit dhe Injaco Silones. (Bardh Rugova).

HOXHA Genc (1957-). Futbollist, trajner. Lindi në Gjakovë. Me futboll nisi të merret që herët, duke i kaluar njërën pas tjetrës grupmoshat e “Vëllaznimit” dhe duke u bërë lojtar i rëndësishëm i skuadrës në vitet ’80, në kohën kur bënte gara në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. Pas luftës së fundit u bë trajneri me më shumë trofe në Kosovë: fitoi dy herë titullin e kampionit të Kosovës me “Besën” e Pejës (2004/05 e 2005/06) dhe Kupën e Kosovës me “Vëllaznimit” në vitin 2008. Është trajner i “Vëllaznimit”, kurse për një kohë të shkurtër e ka drejtuar edhe “Hysin”. Po ashtu është pjesë e stafit teknik të trajnerëve të kombëtares së Kosovës në futboll. (Moral Pozhegu)

HOXHA Gëzim (1955-). Studiues, arkeolog, historian. Lindi në Shkodër, ndërsa studimet për histori dhe gjeografi i kreu në Universitetin e Tiranës. U specializua për arkeologji dhe nga viti 1983 punon si arkeolog i Institutit të Arkeologjisë në Tiranë. Në vitin 1996 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës, ndërsa në vitin 2000 fitoi titullin “Mjeshtër kërkimesh”. Mori pjesë dhe drejtoi një sërë ekspeditash arkeologjike në Shqipërinë e Veriut, në Kosovë dhe në Malin e Zi, duke i përqendruar kërkimet kryesisht në arkeologjinë e provincës së antikitetit të vonë në Praevalitana, në qytetet Shkodër dhe Lezhë. Është autor i monografisë “Scodra dhe Praevalis në antikitetin e vonë” (2003), bashkautor i vëllimeve “Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimore” (2003), “Harta arkeologjike e Kosovës I” (2006) etj. Ka botuar një sërë artikujsh shkencorë në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe tubime shkencore ndërkombëtare. (Gjon Berisha)

HOXHA Hajredin (1926-1987). Sociolog, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Lindi në Shtime, ku e mbaroi shkollimin fillor. Që në moshë të re u aktivizua në brigadat partizane të LNÇ-së. Pas mbarimit të luftës ushtroi disa funksione politike në ish-Jugosllavi.



HAJREDIN HOXHA

Ishte deputet i Dhomës së Kombeve në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë. Pas kryerjes së studimeve u mor me punë pedagogjike dhe shkencore. Në vitin 1960 zgjidhet ligjërues për lëndën e sociologjisë në Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Magjistroi në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit, ndërsa doktoroi në Universitetin e Lubjanës. Ushtrroi funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë edhe detyrën rektorit të Universitetit të Prishtinës. Gjithashtu ishte i angazhuar në institucionet politike dhe shtetërore. Fushë kryesore e studimeve të tij ishin të drejtat e pakicave kombëtare në ish-Jugosllavi, nacionalizmi, partitë politike etj. Ka botuar shumë artikuj nëpër revista shkencore të kohës. Pas vitit 1981 ishte aktiv në fushatën kundër nacionalizmit shqiptar, stalinizmit dhe enverizmit. Ka botuar disa punime në formë të broshurave, që i referohen pozitës së shqiptarëve në ish-Jugosllavi. (Shemsi Krasniqi)

HOXHA Efendi Hajrullah (1939-). Titullar i fesë islame, botues. Lindi në fshatin Korroticë të Epërme të Drenasit. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes dhe në Komoran, Medresenë e Ulët e kreu në Prishtinë. Mësimet e mesme i kreu në Medresenë “Gazi Hystreg beg” në Sarajevë (1963). Pas mbarimit të medresesë kreu detyrën e imamit në Deçan, pastaj në Mitrovicë. Më 1980 u emërua administrator në kryesinë e Shoqatës së Ylemave në Prishtinë, ku punoi deri në vitin 1998, pastaj kaloi në kryesinë e Bashkësisë Islame, si sekretar i redaksisë për botime islame, detyrë që e kreu deri në pension (2005). Është autor i “Takvimit” që nga themelimi i tij (1970), si dhe bashkëpunëtor i rregullt i revistës “Edukata islame”, në të cilën ka të botuara një sërë shkrimesh nga fusha e historisë islame. Ishte edhe kryeredaktor i revistës “Edukata islame” (1988-1990) dhe botoi shkrime edhe në “Takvim” dhe në revistën “Dituria islame”. (Ramadan Shkodra)

HOXHA Haki (1919-2007). Gazetar. Lindi në Isniq të Deçanit. Shkollën fillore dhe gjimnazin

i mbaroi në Pejë, ndërsa studimet për drejtësi në Universitetin e Beogradit. Me gazetari nisi të merrej që nga vitet e luftës antifashiste, kur redaktoi publikimin "Pararoja" të Brigadës së Tretë Shqiptare. Pas përfundimit të luftës, kur nisi botimi i gazetës "Rilindja", u angazhua në ekipin që nxorën numrat e parë të kësaj gazete. Fillimisht punoi si gazetar, kurse në vitet në vazhdim, deri në daljen e tij në pension më 1980, ishte redaktor dhe zëvendëskryeredaktor (1970-1980). Përgatiti shumë breza gazetarësh përmes kurseve e ushtrimeve në kuadër të "Rilindjes". Ka shkruar reportazhe, komente, skica, analiza dhe një numër tekstesh nga fusha e ekonomisë. (Zenun Çelaj)

HOXHA Hysni (1933-). Studiuës i letërsisë. Lindi në Radolishtë të Strugës. Shkollimin fillor e kreu në Strugë, ndërsa Shkollën Normale në Shkup. Studioi letërsinë botërore në



HYSNI HOXHA

Fakultetin Filozofik në Beograd, studimet pasuniversitare i ndoqi në Zagreb, ndërsa doktoratën e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Në fillim punoi si mësues në vendlindje, më pas gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja" dhe në Radio Prishtinë. Një kohë të gjatë ishte profesor i letërsisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Veprat e botuara: "Struktura e vargut shqip" (1973), "Kritika" (1977), "Struktura e vargut të këngëve kreshnike" (1987), "Teoria e novelës dhe e tregimit" (1998). E nisi krijimtarinë me poezi, të cilat filloi t'i botonte në revistën "Jeta e re" që në vitin 1952. Më pas iu përkushtua studimit të letërsisë dhe kritikës letrare. Studimi i tij për vargun e këngëve kreshnike ishte ndër të parët që orientuan studimin e këtyre këngëve në aspektin e strukturës së ndërtimit. Studimet e tij në përgjithësi vënë theksin mbi aspekte të vargëzimit shqip dhe hapin shtigje edhe për studime të tjera të formave letrare. (Kujtim Rrahmani)

HOXHA Imam Hysni (1914-1991). Titullar i fesë islame. Lindi në Gjakovë, mësimet e para fetare i mori në vendlindje, më pas i vazhdoi në Tiranë, ku kreu edhe Medresenë e Lartë të Tiranës. Në vitin 1934 i vazhdoi studimet në Universitetin e "Al-Az-har-it" në Kajro, ku u

diplomua në shkencat islamike. Për shkak të vendosjes së sistemit komunist, nuk u kthye në atdhe. Në fund të viteve '50 u shpërngul në Xheda të Arabisë Saudite, ku punoi si mësimsdhënës shkollë. Në fillim të viteve '70 u shpërngul në SHBA. Në fillim punoi si imam në Vuterburung të Nju-Jorkut, më pas u zhvendos në Çikago, ku u emërua imam në Qendrën Islame Shqiptaro-Amerikane. U mor edhe me shkrime, të cilat i botoi në shtypin shqiptar që dilte në Amerikë. Vdiq në Çikago. (Qemajl Morina)

HOXHA Imam Isa (1918-2001). Titullar i fesë isalme. Lindi në fshatin Bytyç, rrethi i Tropojës. Mësimet e fesë i nisi në Tropojë, ndërsa një vit ishte në Medresenë e Madhe të Gjakovës, kurse vitet e tjera i vazhdoi në Medresenë e Tiranës. Ishte pjesëmarrës aktiv në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe më pas kundërshtar i sistemit komunist. Ishte përkrahës i Lëvizjes së Kryezinjve të Gjakovës. Më 1949 iku nga Shqipëria dhe deri më 1959 qëndroi në ish-Jugosllavi. Më pas u vendos në Triestë dhe më 1962 shkoi në SHBA. Pas themelimit të Qendrës Islamike Shqiptaro-Amerikane në Bruklin, mori detyrën e imamit për shtetet Nju-Jork dhe Nju-Xhersi. Krahas veprimtarisë fetare, zhvilloi aktivitet atdhetar, kulturor dhe arsimor. Ishte në krye të demonstratave, që atëbotë u organizuan në Nju-Jork e Uashington. Shkroi dhe botoi një sërë artikujsh dhe studimesh rreth çështjeve fetare e filozofike, të cilat i publikoi në revistën "Përpjekja jonë", që botohej në Nju-Jork nga Qendra Islamike Shqiptaro-Amerikane. Në vitin 2010, presidenti i Shqipërisë e dekoroi me Urdhrin "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". (Resul Rexhepi)

HOXHA Isak (1947-). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Zhur të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën Normale në Prizren. Diplomoi në degën e matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Më pas zgjidhet asistent në Fakultetin Teknik (1973). Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit, ndërsa tezën e disertacionit nga lëmi i analizës funksionale e mbrojti në FSHMN të UP-së (1989). Për qëllime studimore qëndroi në Minsk, Bjellorusi (1987-1988). Në vitin 1982 zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Ndërtimtarisë

dhe të Arkitekturës të UP-së, ku gradohet edhe në titujt e tjerë universitarë. Ligjëroi disa kurse në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës dhe në FSHMN të UP-së, në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik në Mitrovicë, në Fakultetin e Bujqësisë dhe në Universitetin e Prizrenit. Mori pjesë në disa tubime shkencore, botoi punime shkencore dhe është hartues i teksteve universitare. (Minir Efendija)

HOXHA Ismail (1934-1999). Kompozitor dhe autor tekstesh shkollore të muzikës. Lindi në Ladorisht të Strugës (Maqedoni). U shkollua në Strugë dhe Tetovë, ndërsa Akademinë e Arteve, drejtimi teorik-pedagogjik, e kreu në Shkup. Ishte pedagog i muzikës në shkolla fillore dhe të mesme në Maqedoni, në Normalen e Prishtinës (1963-1966), këshilltar në Entin Krahinor për Përparimin e Shkollave, profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Shkupit (1985), bashkëpunëtor e redaktor i muzikës në Radio-Prishtinë dhe Radio-Shkup. Ishte ndër themeluesit e degës së artit muzikor dhe dekan i Fakultetit të Arteve (1994-1998) në Universitetin e Tetovës, si dhe themelues i festivaleve “Këngë jeho” dhe “Sharri këndon”. Kompozoi mbi 150 këngë për fëmijë, një numër këngësh popullore, të muzikës së lehtë dhe këngë korale. Ishte pjesëmarrës i rregullt në “Akordet e Kosovës”. Ishte autor i teksteve shkollore për lëndën e edukatës muzikore: “Ejani të këndojmë” (1976), “Notat e arta” (1977), “Tingujt magjepsës” (1978), “Këndoni me nota” (1979), “Abetarja e muzikës” (1987), “Notat e hareshme” (1996) etj. dhe autor i përmbledhjes me këngë për pionierë “Tingujt e hareshëm” (1999). Bashkëpunoi me Teatrin e Kombësive në Shkup, me Teatrin e Kukullave në Prishtinë etj. Ishte fitues i çmimeve dhe mirënjohjeve. (Indira Çipa)

HOXHA Jahi (1943-). Fizikan, profesor universitar. Lindi në fshatin Cërrnicë, komuna e Gjilanit. Shkollimin fillor dhe Normalen i kreu në Gjilan (1964), ndërsa studimet për fizikë i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1969). Punoi mësimdhënës i fizikës në Shkollën Normale të Prishtinës, kurse më pas zgjidhet asistent në katedrën e fizikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP). Në vitin 1983 zgjidhet ligjërues i disa lëndëve në

degën e matematikës. Studimet pasuniversitare i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1982), ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në FSHMN të UP-së (1987). Publikoi punime shkencore dhe mori pjesë me kumtesa në tubimet shkencore ndërkombëtare dhe vendore. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e shkollimit të lartë në Kosovë. (Rexhep Gashi)

HOXHA Kumrije (1953-). Aktore. Lindi në Prishtinë. Shkollën e Mesme të Baletit e kreu në Shkup, ndërsa aktrimin në degën e artit dramatik në Shkollën e Lartë Pedagogjike në



KUMRIJE HOXHA

Prishtinë. Kariirën e aktores e filloi në Teatrin Popullor Krahinor në vitin 1973, ku luajti role të shumta në shfaqjet: “Me sytë e klounit”, “Hotel kashta”, “Mizantropi”, “Fundi i botës”, “Ah, Xho”, “Orkideja”, “Martesa”, “Shpend Sokoli i Sokol Shpendit”, “Venedikasja”, “Trenat”, “Historia e atyre që s’janë”, “Prefekti”, “Dan Shejtani”, “Fundi i lojës”, “Hana prej letre” etj. Aktroi edhe në filma dhe drama televizive, si: “Të ngjuarit”, “E kafshoja terrin”, “Buka e hidhur” dhe në serialin për fëmijë “Fidani”. Për punën dhe kontributin shumëvjeçar në teatër u shpërblye me mirënjohje në vitin 2006 dhe 2008. (Selman Jusufi)

HOXHA Kushtrim (1978-). Aktor. Lindi në Gjakovë. Pas mbarimit të studimeve për aktrim në Prishtinë, studioi në “Greensboro College” në Karolinën e Veriut në SHBA dhe në teatrin “Old Glob” në Universitetin e San Diegos (2014). Herët u paraqit në Teatrin “Dodona”, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë dhe në Teatrin e Gjakovës. Shfaqjet ku ishte pjesëmarrës u prezantuan në disa festivale teatrore brenda dhe jashtë vendit. Luajti në shfaqjet “Mbreti Lir” në regji të F. Hysajt, “Roch&roll” në regji të D. Mustafiqit në Teatrin Kombëtar të Kosovës, ndërsa në SHBA luajti në shfaqjen “Majmuni i Diellit” në regji të O. Tenquistit, pastaj në “Othello” në regji të B. Edelstien, “Princi Hall” në regji të R. Chavkin, “Rozenkranc dhe Guild janë të vdekur” në regji të A. Noble dhe “Shumë zhurmë për asgjë” në regji të J. Newcomb. Në televizion u paraqit në serialin televiziv

“Familja moderne”, ndërsa në SHBA në serialin amerikan “Elementary”. (Jeton Budima)

HOXHA Mehmedali (1924-1991). Poet, gazetar, pedagog. Lindi në Ladorishtë të Strugës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme, Medresenë e Gazi Isa Beut, në Shkup. Vazhdoi kursin pedagogjik në Normalen “Sami Frashëri” në Prishtinë. Punoi si mësues, pedagog, gazetar dhe shkrimtar. Ishte redaktor i gazetës së përditshme “Flaka e vëllazërimit”, themelues dhe redaktor i revistës për fëmijë “Fatosi”, hartues i abetareve dhe teksteve shkollore, si dhe autor i shumë artikujve. Veprimtaria letrare e M. Hoxhës përfshin botimet: “Vjersha” (1952) (bashkë me L. Rusin), “Te kroni” (1960), “Kur fryn era” (1962), “Atje mbi kodrinë” (1974), “Ditët tona” (1979), “Këngë shkollore” (1984), “Kur linda” (1971), “Në sytë e majit” (1973), “Vashëzat shkollare” (1976), “Qepallat e verës” (1985), “Ma thuaj emrin” (1989), “Një brez livadh” (1990). Vjershat e M. Hoxhës shquhen për pasurinë e motiveve, larminë e temave. (Fatmir Sulejmani)

HOXHA Mehmet (1908-1987). Luftëtar dhe funksionar politik i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në Gjakovë, ndërsa të mesmen në Shqipëri. Ishte prefekt i Elbasanit. U përfshi në Luftën Nacionalçlirimtare nga viti 1941. Ishte kryetar i parë i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe të Metohisë (Dukagjinit). Në vitin 1943 u burgos dhe u internua, ndërsa pas kapitullimit të Italisë u lirua nga burgu. Në periudhën 1944-1945 ishte anëtar i Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe i Këshillit Krahinor për Kosovë e Metohi (Dukagjin), pastaj kryetar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar i Kosovës, kryetar i konferencës dhe bashkëhartues i Rezolutës së Bujanit. Pas Luftës së Dytë Botërore ushtroi funksione me përgjegjësi në organet drejtuese të Serbisë dhe të Federatës Jugosllave. U mor edhe me letërsi dhe me përkthime. Përktheu disa vepra nga serbokroatishtja dhe frëngjishtja në gjuhën shqipe. (Daut Bislimi)

HOXHA Mustafë (1915-1995). Lindi në Nishfec të Gallapit. Medresenë e kreu në Prishtinë. Në fshat shërbeu si imam, ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botërore ra në kontakt me veprimtarët komunistë dhe përkrahu luftën an-

tifashiste. Një kohë bashkëpunoi me Meto Bajraktarin dhe Zenel Salihun, me ç’rast formojnë çetën e Brainës (1942). Çeta më 1943 u avancua në batalion. Në fund të vitit 1944 Batalioni “Meto Bajraktari” (pas vrasjes së Meto Bajraktarit) avancohet në brigadë. Deri në maj 1945 M. Hoxha ishte i angazhuar në aradhet partizane. Ishte kryetar i rrethit të Llapit, por shpejt u shkarkua nga kjo detyrë. Më pas u angazhua me veprimtarinë e shoqatave fetare. Pas Plenumit të Brionëve (1966) u rehabilitua politikisht dhe u emërua komandant i Mbrojtjes Territoriale për komunën e Podujevës. Është i njohur veprimi i tij për kundërshtimin e hyrjes së oficerëve dhe ushtarëve jugosllavë në Llap pas demonstratave të vitit 1981. (Hakif Bajrami)

HOXHA Njazi (1946-2017). Inxhinier i ndërtimtarisë, mësimsdhënës universitar. Lindi në Kaçanik, shkollën fillore e kreu në Kaçanik, ndërsa shkollën e mesme të ndërtimtarisë në Mitrovicë. Studimet i kreu në Fakultetin e Ndërtimtarisë të Universitetit të Beogradit (1969). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. U zgjodh asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Prishtinë, më pas ligjërues dhe ligjërues i lartë (1997) për lëndën konstruksionet e betonit. Ishte deputet i Kuvendit të Kosovës në përbërjen që më 1990 shpalli Deklaratën Kushtetuese. Periudhën 1990-1997 e kaloi në Kroaci, Zvicër dhe Çeki, ku vazhdoi aktivitetin profesional. Ishte i angazhuar në shumë projekte, në cilësinë e koordinatorit, të mbikëqyrësit të projekteve të ndërtimit dhe të hartuesit të ekspertizave të ndryshme. Kreu detyra udhëheqëse në institucione dhe në organizata punuese, përfshirë postin e drejtorit të përgjithshëm të Kombinatit “Ramiz Sadiku” në Prishtinë. (Misin Misini).

HOXHA Pranvera (1983-). Pianiste. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës për piano. Kreu studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë, studimet e magjistraturës në Fakultetin e Muzikës në Shkup. Mori pjesë në festivalet: “Java e Bachut”, Festivali i muzikës kamerale, i Shopenit në Tiranë dhe Prishtinë, në “DAM Festival”, “Remusica”, “Tingujt e Flautit” etj. Ka realizuar dhe recitale në periudhën midis viteve 1998-2012. Në 5-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës mbajti koncert në Bruksel dhe Prishtinë, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e



PRANVERA HOXHA

Kosovës. Ka bashkëpunuar me Filarmoninë e Kosovës, si korrepetitore, ndërsa si soliste në koncertin festiv të Filarmonisë me “Fuga” të A. Piazzola-s. Është anëtare e Orkestrës Kamerale “R. Mulliqi”, me të cilën realizoi koncerte

në Kosovë dhe Paris. Në Akademinë Europiane të Muzikës ishte korrepetitore (2012, 2013 dhe 2015). Është korrepetitore në klasën e flautit e klarinetit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës dhe në Pejë, si dhe profesore e pianos në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. (Arnisa Rexhepi)

HOXHA Qamil (1919-1945). Agronom. Lindi në Skënderaj. Shkollën fillore e filloi në vendlindje dhe e mbaroi në Krumë të Hasit. Kreu shkollën e mesme bujqësore amerikane në Golem të Kavajës më 1938. Punësohet drejtor i fidanishtes në Skivjan, afër Gjakovës dhe në të njëjtën kohë përkujdeset edhe për fidanishten në Skënderaj. Dha kontribut në aftësimin profesional dhe praktik për ngritjen e fidanishteve: shartimin si operacion i veçantë, prodhimin e fidanëve të mirëfilltë si parakusht për suksesin e një pemishteje. Në vitin 1945 pushkatohet në Skënderaj, pa gjyq, duke iu zhdukur çdo gjurmë. (Agim Zajmi)

HOXHA Ramiz (1927-2015). Lindi në Kolgecaj të Bajram Currit. Shkollën fillore e kreu në Krumë, normalen në Gjakovë. Studioi albanologjinë në Fakultetin Filozofik në Beograd. Fillimisht ishte nëpunës, pastaj mësues në Istog, mësimdhënës në gjimnazin e Gjakovës, përkatësisht të Prishtinës (1954-1962), redaktor dhe kryeredaktor i revistës “Shëndeti” (1962-1969) dhe kryeredaktor në Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Kosovës në Prishtinë. Është autor i “Abetares” (1966), i një libri të leximit për klasën VI, si dhe bashkautor i disa teksteve të tjera mësimore të shkollës fillore dhe të mesme. Publikoi disa punime dhe artikuj në gazeta e revista në Kosovë. (Demë Hoti)

HOXHA Rexhep (1929-). Shkrimtar, profesor. I takon brezit të parë shkrimtarëve për fëmijë në Kosovë. Lindi në Gjakovë. Mbaroi shkollën fillore dhe Normalen në Gjakovë, ndërsa



REXHEP HOXHA

studimet për gjuhë shqipe dhe letërsi i kreu në Beograd. Një kohë punoi si mësues në Pogradit të Gjilanit e pastaj profesor në Normalen e Gjakovës dhe të Prishtinës dhe në gjimnazin e Mitrovicës. Më vonë, deri në pensionim,

ligjëroi lëndën letërsi për fëmijë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Punoi edhe si redaktor në “Rilindjen për fëmijë” dhe në emisionet për fëmijë të Radio Prishtinës. Është autor i librit të parë për fëmijë të botuar pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë (“Gjethë të reja”). Botoi edhe libra të tjerë për fëmijë dhe për të rritur me poezi, tregime, romane për fëmijë, libra me poezi për të rritur, si dhe shkrime diskursive për letërsinë etj. Me librat e tij u rritën breza të tërë shkollarësh në Kosovë, sidomos atëherë kur kishte pak libra shqip. Në poezinë tonë për fëmijë ai u bë i njohur me personazhin e tij Picimuli, një fëmijë simpatik, i cili lexuesve të vegjël u shërbeu si shembull i mirë në rritje dhe edukimin e tyre të shëndetshëm. Romani “Lugjet e verdha” vjen si roman i parë i mirëfilltë në letërsinë shqipe për fëmijë në përgjithësi, i cili, si edhe disa romane të tjera të tij (“Verorja”, “Lugjet e verdha” II) ndërtohet nëpërmjet gërshetimit të përrallës me motive reale. Hartoi edhe tekste shkollore. Veprat e botuara: “Gjethë të reja” (1953), “Picimuli” (1956), “Mbi krahët e fluturës” (1959), “Pika vese” (1966), “Lugjet e verdha” (1967), “Vargu idhnaq” (1971), “Micimiri” (1976), “Lulëzo, vendi im” (1973), “Zëri i pyllit” (1974), “Tokë trëndafilash” (1979), “Verorja”, (1983), “Zogu i qiellit” (1984), “Kënga e Çupërliques” (1989), “Picimuli në Poroj” (2000) etj. (Xhevat Sylja)

HOXHA Sali (1925-1985). Luftëtar i Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Lindi në Pejë. Shkollën fillore e kreu në Pejë, kurse shkollën e mesme - Medresenë në Shkup. Pas kthimit në Pejë përfshihet në Lëvizjen Antifashiste me shumë të rinj nga Peja. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore angazhohet në rindërtimin e vendit. Si ish-pjesëmarrës i luftës, kreu detyra me përgjegjësi në komunën e Pejës. Një kohë ishte sekretar i Komitetit Komunal në Pejë. Hapjen e shkollave turke në Kosovë dhe në Pejë, S.Hoxha e kundërshtoi me vendosmëri.

Për këto qëndrime iu nënshtrua kritikatave të shumta nga nacionalistët serbë e malazias. Për pasojë, u largua nga pozita e sekretarit të Komitetit Komunal dhe u caktua drejtor i shkollës fillore “Ramiz Sadiku”. Pas Plenumit të Brioneve kreu detyra me përgjegjësi në administratën e komunale të Pejës. Në të gjitha pozitave që mbajti u shqua si funksionar me autoritet dhe kontributdhënës për përfshirjen e shqiptarëve në vendimmarrje në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ishte i nderuar nga qytetarët e Pejës. (Kosovar Basha).

HOXHA Sejdullah (1948-). Mjek, gjinekolog, mësime universitar. Lindi në fshatin Zhur, komuna e Prizrenit. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prizren, studimet në



SEJDULLAH HOXHA

Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1977). Një kohë punoi në Qendrën Mjekësore në Prizren dhe si mësime në shkollën e mesme të mjekësisë. Prej vitit 1979 deri më 1990 punoi në Klinikën Gjinekologjike në Prishtinë. Në vitin 1986 u emërua drejtues i maternitetit në Poliklinikën humanitare “Nënë Tereza” në Prishtinë. Po atë vit u zgjodh asistent i lëndës gjinekologjike me obstetrikë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ndërsa vijoi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë. Pas luftës, më 1999, u emërua drejtor i Klinikës së Gjinekologjisë me Obstetrikë në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Mbrojti tezën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë në vitin 2000. Një mandat ishte deputet i Kuvendit të Kosovës. Ka marrë pjesë në kongrese e simpoziume dhe ka publikuar disa punime shkencore si autor dhe bashkautor. (Zylfi Azizi)

HOXHA Skënder (1931-2001). Grafist, piktor. Lindi në Gjakovë. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Pejë më 1954. I takonte gjeneratës së parë të nxënësve të kësaj shkolle kur shfaq interesimin për grafikë, në veçanti për drugdhendje, me të cilën pasqyrore motivet e vjetra të qyteteve të Kosovës. Konsiderohet nismëtar i grafikës në Kosovë. Publikonte në shtypin e asaj kohe, kryesisht në gazetën “Rilindja”. Ishte anëtar dhe njëri ndër themeluesit

e Klubit të Artistëve Figurativë të Kosovës, më vonë të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës. Në vitin 1955 u punësua në shkollën fillore “Meto Bajraktari” në Prishtinë, si mësues vizatimi, ndërsa më vonë redaktor teknik në gazetën “Rilindja”, kurse nga viti 1972 në Entin e Teksteve Mësimore të Kosovës. Më vonë, nga viti 1973, punoi maketar në Entin për Urbanizëm në Prishtinë deri në pensionim më 1986. (Fatmir Krypa)

HOXHA Skënder R. (1949-). Shkrimtar. Lindi në fshatin Jabllanicë të Dushkajës, rrethinë e Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Zhabel, gjimnazin në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Gjakovë, përkatësisht në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Tetovës. Punoi si mësues në fshatrat e Gjakovës dhe të Pejës dhe, së fundi, në Shkollën Teknikë të Pejës. Shkruan poezi dhe prozë për të rritur dhe për fëmijë, ese, publicistikë, kritikë letrare, tema gjuhësore etj. Nga viti 1969 shkruan e tij i gjejmë në periodikun letrar e shkencor. Nga këto fusha botoi një sërë veprash: “Dy akte të dramës së pakryer” (1997), monografinë “Toponimia e Dushkajës” (2007), studimin monografik “Rrugëtimi për në Panteon” (2009) etj. (Hasan Hasani)

HOXHA Shëfqet (1953-). Instrumentist, kompozitor, orkestrues. Lindi në Ferizaj, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm. Akademinë e Muzikës e kreu në Sarajevë. Filloi me muzikë që më 1963, me grupin “Simpatikët” (Ferizaj), më pas formoi grupin “The Lords”. Bashkëpunoi me “Dogri Yoll” e “Telstar” deri më 1973. Në Sarajevë ishte ndër themeluesit e drejtimit të kitarës në shkollën e muzikës. Më 1975 iu bashkëngjiti grupit muzikor “Rezonanca”, si kitarist, me të cilin bëri tri albume. Më 1977 në Sarajevë iu bashkua grupit “Divlje jagode” dhe ishte ndër themeluesit e grupit “Vatreni poljubac” si bas-kitarist, me të cilin bëri pesë albume. Më 1983 formoi grupin “Carski rez” ku ishte bas-kitarist, në tastiera e kompozitor, ndërsa më 1985 grupin “Detektor lazi”, si bas-kitarist e kompozitor. Më 1985 u kthye në Prishtinë dhe u bë anëtar i Orkestrës Revyale të RTV Prishtinës deri në largim nga puna më 1990. Jetoi një kohë në Sofje, ku u prezentua me emra të njohur në lëmin e xhaz-muzikës, si: Marcus Miller, Stanley Clark, Billy Cobham,

Nigel Kennedy. Më 1999 formoi grupin e xhaz-muzikës “Sheki Internacional Band”, me të cilin nxori albumin “Kosova Blues”. Me 2003 u kthye në Prishtinë si anëtar i “Big Bend”-it të Radiotelevizionit të Kosovës, ku vazhdon edhe sot. Mori pjesë në festivale, ka punuar me të rinj dhe ka kontribuar për hapjen e drejtimit për kitarë në shkollat e muzikës në Prishtinë e Prizren. (Xhevdet Gashi)

HOXHA Shqipe (1952-). Balerinë. Lindi në Prizren. Shkollën e mesme të baletit e kreu në Shkup. Në ansamblin e baletit në Tetarin Popullor Krahinor u inkuadrua në vitin 1972. U paraqit në skenë me një sërë interpretimesh në shfaqjet e baletit: “Ritme të zgjuara”, “Paralojë dasme”, “Legjenda mbi ngadhënjimin”, “Halili e Hajria”, “Bolero dhe Shtausiada”, “Interplay”, “Kopelia”, “Era dhe kolona”, “Romeo dhe Zhuljeta”, “Balloja e kadetëve”, “Baresha”, “Don Kishoti”, “E bukura More”, “Pjetër Pani”, “Loja e Sizifit”, “Fyelltari” etj. (Selman Jusufi)

HOXHA Veton (1952-). Mjek, stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, arsimimin bazë e mori në vendlindje, kurse studimet i kreu në Fakultetin e Stomatologjisë



VETON HOXHA

në Beograd (1977). Pas diplomimit punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Mbaroi specializimin për sëmundjet e gojës dhe të dhëmbit në Fakultetin e Stomatologjisë në Sarajevë, studimet pasuniversitare në Beograd, ndërsa doktoratën e mbrojti në Sarajevë (1984). Ndërkohë, më 1982 u zgjodh asistenti në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës dhe më pas merr titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar më 1998. Gjatë viteve 1986-1987 si bashkëpunëtor shkencor qëndroi në Turqi. Në periudhën 2000-2001 ushtroi detyrën e drejtorit gjeneral të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Prej vitit shkollor 1986/1987 e deri në vitin 2010 ushtroi detyrën e shefit të lëndës për sëmundjet e dhëmbit me endodoncion. Është anëtar i shumë asociacioneve ndërkombëtare të endodontëve të Europës dhe të Turqisë, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Europës dhe kryetar i Shoqatës së

Endodontëve të Kosovës. Është autor i tekstit universitar “Sëmundjet e dhëmbit” dhe autor e bashkautor i shumë punimeve profesionale dhe shkencore. (Fatmir Dragidella)

HOXHAJ Enver (1969-). Historian, mësimdhënës universiteti, politikan. Lindi në Suharekë, shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në vendlindje, studimet në departamentin e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP), ndërsa studimet pasuniversitare i vazhdoi në Universitetin e Vjenës. Atje ndoqi ligjërata në drejtimit e shkencave të historisë dhe të politikës dhe më vonë e mbrojti



ENVER HOXHAI

temën e doktoratës po në këtë universitet (2000). Më pas, në UP, në departamentin e shkencave politike të Fakultetit Filozofik mori statusin e mësimdhënësit. Ishte bashkëpunëtor shkencor i Universitetit të Vjenës dhe i Shkollës Ekonomike të Londrës. Ka publikuar disa punime shkencore në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dhe ka mbajtur ligjërata në disa universitete, në Europë dhe në SHBA. Është autor i librave: “Politika etnike në Kosovë” (2005), “Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës” (2008) dhe “Ngritja e një shteti” (2016). Ishte pjesë e delegacionit kosovar në bisedimet e Vjenës, për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Pas shpalljes së Pavarësisë (2008), ishte ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë dhe më vonë ministër i Jashtëm i Republikës së Kosovës, si dhe deputet i Kuvendit të Kosovës. (Alfred Marleku)

HOXHA-ZAJMI Drenusha (1970-). Shkrimtare, publiciste. Lindi në Prizren. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. Kreu studimet universitare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Shkruan tekste publicistike, të cilat i boton kryesisht te e përditshmja “Koha ditore”. Është mjaft e përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes angazhimit në projekte edukuese e bamirëse. Me shkrime letrare është marrë që në moshë të re. Shkruan letërsi për fëmijë, poezi dhe prozë për të rritur. Në vitin 2009 botoi romanin e saj të parë “Engjëjt vdesin ndryshe”, me të cilin fitoi çmimin “Hivzi

Sylejmani”, pastaj librat për fëmijë “Vishe botën me buzëqeshje” (2011) dhe “Eko Librus dhe misioni për shpëtimin e planetit” (2013). Po në vitin 2013 botoi romanin e dytë “Krrokamat”, për të cilin mori çmimin “Azem Shkreli” nga Ministria e Kulturës për romanin më të mirë. (Munish Hyseni)

HOXHIQ-BERISHA Zuvdija (1943-). Prozator dhe publicist malazias me origjinë shqiptare. Lindi në Guci. Nga viti 1962 jeton në Podgoricë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi si gazetar në Podgoricë. Ishte kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Kulturore të Malit të Zi, redaktor në revistën “Almanah”, sekretar i PEN Qendrës të Malit të Zi dhe redaktor përgjegjës i revistës “Kos”. Botoi përmbledhjen me poezi “Në hapin e parë”, pastaj librat me tregime “Zilet e shurdhëta” dhe “Dikush thërret” dhe romanet “Viti i Gucisë” dhe “Ylli i Davidit”. Të dy romanet janë përkthyer në shqip, kurse “Ylli i Davidit” edhe në polonisht dhe italisht. Është fitues i Çmimit “13 korriku”. Konsiderohet nga prozatorët e parë modernë në Mal të Zi, i përfshirë në lektura shkollore, edhe në shkolla shqipe në Mal të Zi. Është anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi. (Haxhi Shabani)

HRABAK Bogumil (1927-2010). Historian serb, profesor universiteti, akademik. Lindi në Zrenjanin të Vojvodinës (Serbi). U diplomua për histori në Beograd, ndërsa disertacionin e doktoratës e mbrojti në Sarajevë (1957). Punoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit (1951–1957), një kohë të shkurtër ishte punëtor shkencor në Institutin Ushtarak-Historik të Armatës Popullore të Jugosllavisë, punëtor shkencor në Institutin e Shkencave Shoqërore (1958-1965) në Beograd, ligjërues dhe themelues i katedrës së historisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1965-1979). Ishte edhe drejtor i Institutit për Historinë e Lëvizjes Punëtore të Kosovës (1976-1977) dhe mësimdhënës në Fakultetin Filozofik të Novi-Sadit (1979-1993), ku edhe u pensionua. Mori pjesë në themelimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1975) dhe ishte anëtar i saj (1978-1990). B. Hrabak hulumtoi materiale arkivore në qendra të ndryshme të ish-Jugosllavisë dhe të Europës. Veprimtaria e tij shkencore

përfshin historinë ekonomike të mesjetës së vonë, periudhën osmane-venedikase në tërësi, Luftën e Parë Botërore, historinë politike dhe ekonomike të Jugosllavisë (1918-1941) dhe politikën e jashtme të Jugosllavisë (1945-1965). Publikoi disa punime për relacionet tregtare të viseve bregdetare shqiptare dhe të Kosovës me Republikën e Raguzës në mesjetën e vonë, si dhe disa të tjera për kryengritjet shqiptare në fillim të shek. XX. Veprat e tij kryesore për shqiptarët janë: “Eksportimi i drithërave nga Perandoria Osmane gjatë shek. XIV, XV, XVI” (1971), “Kryengritja shqiptare 1912” (1975), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881” (1998), “Xhemijeti: organizatë e myslimanëve të Maqedonisë, të Kosovës, të Dukagjinit dhe të Sanxhakut 1919-1928” (2003) etj. (Qerim Dalipi)

HUAJA PUBLIKE. Huaja publike paraqet borxhin e një qeverie qendrore dhe njëkohësisht është një metodë e financimit të operationeve qeveritare. Qeveritë zakonisht marrin hua, duke lëshuara letra me vlerë, siç janë bonot e thesarit dhe fletobligacionet qeveritare. Qeveritë me nivel më të ulët kreditor ndonjëherë marrin hua drejtpërdrejt nga organizatat me karakter mbinacional (për shembull Banka Botërore) ose institucionet financiare ndërkombëtare. Meqenëse qeveria siguron pjesën më të madhe të të ardhurave nga taksapaguesit, atëherë del se borxhi i qeverisë është një borxh indirekt i taksapaguesve. Borxhi i qeverisë mund të kategorizohet si borxh i brendshëm (që u detyrohet huadhënësve brenda vendit) dhe borxh i jashtëm (që u detyrohet huadhënësve të huaj). Një ndarje tjetër e zakonshme e borxhit të qeverisë është sipas afatit kohor. Borxhi afatshkurtër në përgjithësi konsiderohet të jetë për një vit ose më pak se një vit, ndërsa borxhi afatgjatë është për më shumë se dhjetë vjet. Borxhi publik i Kosovës në fund të vitit 2014 kishte arritur në 582,9 milionë euro, nga 476,3 milionë euro sa ishte në vitin paraprak, ndërsa si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto ka arritur në masën 10.6%, nga 9.1% sa ishte në vitin paraprak. Rritja prej 22.4% e vlerës së borxhit publik në vitin 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm, ndërkohë borxhi i jashtëm ka mbetur pothuajse i pandryshuar. Borxhi i brendshëm në vitin 2014 arriti në 256,5 milionë euro (152,5 milionë euro në vitin 2014), përderisa

vlera e borxhit të jashtëm ishte 326,4 milionë euro. (Sokol Havolli).

HUATË SHTETËRORE Shih: HUAJA PUBLIKE.

HUMANIZMI DHE RILINDJA NË KOSOVË. Sikurse në Raguzë, Kotorr, Tivar, Shkodër e ndonjë tjetër qytet, ashtu dhe në qytetet e Kosovës, të cilat ruanin marrëdhënie të mira me bregdetin, Humanizmi dhe Rilindja nisi si përpjekje për të ngritur kultin e njeriut dhe për të ringjallur kulturën e antikitetit. Format më të përshtatshme, që u zhvilluan edhe në këtë zonë ishin letërsia dhe artet figurative. Dokumentet arkivore nxjerrin në dritë një numër krijuesish humanistë, sidomos nga qyteti i Novobërdës, të cilët pas rënies së tij nën sundimin osman (1455) u detyruan të emigronin në Itali e Dalmaci.

Njëra ndër figurat më të shquara të Novobërdës ishte Martin Segoni (?-1485), i cili renditet midis humanistëve që u morën kryesisht me tema të luftës kundër invadimit osman në Ballkan. Janë ruajtur disa shkrime latinisht të Segonit, në të cilat bën fjalë edhe për rrugët e Ballkanit, siç ishte rruga që shpinte për në Kosovë (të cilën e quan Dardani), pastaj Rrugën Egnatia etj. Segoni ka lënë edhe një dorëshkrim të shkurtër kushtuar Skënderbeut: "Rrëfim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit, në gjuhën e tyre, i quajtur Skander Beg, domethënë "Aleksandër i Madh", si dhe shkrime të tjera, në të cilat ndeshim fragmente mbi familjen e Skënderbeut, mbi Arbërinë e kohës së tij, si dhe skica jetëshkrimi për historinë e heroit dhe të kohës së tij.

Nga Novobërda në shek. XV dolën edhe autorë të tjerë, si Kostadin Mihali i Ostrovicës së Novobërdës, Dhimitër Kantakuzeni, Kostandin Filozofi, Vladisav Gramatiku, të cilët shkruanin greqisht. Këtu jetoi dhe veproi një kohë historiani bizantin, Jan Kantakuzeni. Krahas Segonit është shquar edhe një historian tjetër i kohës së tij, Kostadin Mihali nga Ostrovica e Novobërdës (rreth vitit 1435-pas vitit 1500). Në veprën e tij për inkursionet osmane në Ballkan dhe për fushatat osmane në viset shqiptare, spikatet roli i Skënderbeut përballë ushtrisë së sulltan Mehmetit II. Vend të rëndësishëm në historinë e Kostadin Mihalit zë rrethimi i Novobërdës dhe pushtimi i saj në vitin 1455. I njohur ishte edhe Valeri Novobërdasi, teolog dhe filozof, i cili përveç punës në disa univer-

sitete të njohura të kohës, pjesën më të madhe të jetës e kaloi në shërbim të papatit. Në këtë kohë shquhet edhe veprimtaria e gjerë e filozofit-teolog, Gjon Vaji, i cili së pari nga gjenerali i urdhrit dominikan dhe pastaj nga papa Nikolla V (më 1450) kërkoi dhe mori leje që, së bashku me disa bashkëvendës, të vepronte lirisht në Kosovë.

Vëmendjen e studiuesve e ka tërhequr edhe veprimtaria e dy krijuesve novobërdas në arte figurative: Gjon Injaci (Johannes Ognenouich) dhe magjistër Gjon Progoni. Për jetën dhe krijimtarinë e tyre ruhen shumë dokumente që dalin nga kancelaria, noteria dhe aktet e këshillave raguzane. Progoni ka tërhequr vëmendjen e Farlatit dhe të Coleti-t. Injaci ishte ndër piktorët dhe pjesëmarrësit më të njohur të shkollës së pikturës novobërdase të realizuar në Raguzë gjatë shek. XV. Injaci qe angazhuar edhe për meremetimin e Pallatit të dukës së Raguzës. (Jahja Drançolli)

HUMNERA E ZGATARIT. Humnerë në fshatin Zgatar, komuna e Dragashit (Opojë). Njihet me emrin Shpella e Madhe. Është e hulumtuar në periudhën 1991-1993. Është e thellë rreth 60 m. Hyrja e humnerës ka gjatësi 12 m dhe gjerësi 8 m. Në fund të kanalit vertikal gjendet galeria e Shpellës. Galeria shtrihet në drejtimin veri-verilindje në gjatësi rreth 65 m, gjerësi rreth 48 m dhe lartësi 26 m. Gjatësia e përgjithshme e korridoreve dhe e galerisë është mbi 100 m. Është krijuar në shkëmbinjtë gëlqerorë shtresorë të kristalizuar të triasikut. DysHEMEJA e humnerës është e mbushur me blloqe të shkëmbinjve të shembur nga tavani dhe nga gurët e hedhur nga jashtë humnerës. Hyrja në humnerë është e mundur vetëm me përgatitje speleologjike. (Fadil Bajraktari)

HUMOLLI Fatmir (1965-). Aktivist i lëvizjes çlirimtare, njëri nga organizatorët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Llap. Lindi në Lupç të Poshtëm, komuna e Podujevës. Ishte pjesë e grupit ilegal "Kosova e re". Në mars të vitit 1984 grupi u dekonspirua dhe F. Humolli u dënua me 3 vjet e gjysmë burg. Aktivitetin politik ilegal e vazhdoi në fillim të viteve '90. Nga viti 1994 u bë anëtar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK-së) dhe veproi në Kosovë e në Shqipëri. Në mbledhjen e dytë të LKÇK-së, që u mbajt në Tiranë, F. Humolli u zgjodh përgjegjës për

çështje ushtarake i kësaj organizate. Punoi për furnizim me armë dhe për krijimin e kushteve për stërvitjen e luftëtarëve. Në verë të vitit 1997 ishte pjesëmarrës në marrjen e vendimit për krijimin e strukturave ushtarake në Llap. Më 12 maj 1998 u godit baza e LKÇK-së në Prishtinë, ku u plagos rëndë. Struktura ushtarake e LKÇK-së, nën përgjegjësinë e tij ishte aktive në krijimin zonave operative të Shalës, Llapit, Karadakut dhe Pashtrikut. Pas luftës zhvilloi aktivitet politik në kuadër të LKÇK-së dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. (Ismet Cakiqi)

HUNDOZI Beqir (1934-). Botanist, profesor universiteti. Lindi në Rahovec, shkollën fillore e kreu në vendlindje, Normalen në Gjakovë, studimet në degën e biologjisë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrortë (FSHMN) të Universitetit të Shkupit (1961). Studimet pasuniversitare në degën e biologjisë i kreu në FSHMN të Universitetit të Zagrebit, disertacionin e mbrojti gjithashtu në Universitetin e Zagrebit (1980). Zgjidhet asistent në lëndën morfologjia e bimëve në katedrën e biologjisë të Fakultetit Filozofik (1966) dhe pastaj në vitet vijuese merr të gjithë titujt universitarë. Është marrë me studimin e florës dhe të vegjetacionit dhe mbi këtë fushë publikoi punime shkencore. Bashkëpunoi në projektin “Hulumtime në florën e Kosovës” dhe kontribuoi në themelimin e herbariumit të florës së Kosovës. Gjithashtu kontribuoi në ngritjen e kuadrit shkencor të kësaj fushe. Është bashkautor i tekstit universitar “Anatomia e bimëve” (1978). Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. (Feriz Krasniqi)

HUNDOZI-HYSENAJ Hajrije (1956-). Mjeko, fiziatër, profesor universiteti. Lindi në Rahovec, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet i mbaroi në Prishtinë, në Fakultetin e Mjekësisë (1981). Fillimisht punoi në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë. Përfundoi specializimin për mjekësi fizikale me rehabilitim në Zagreb (1988). Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitin 1999 mbrojti tezën e doktoratës po në këtë fakultet. Ndërkohë, më 1994 u zgjodh asistente dhe më pas mori të gjithë titujt universitarë për lëndën e mjekësisë fizikale me rehabilitim. Me hapjen e seksionit për mjekësi fizikale me rehabilitim

në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, u emërua drejtuese e këtij seksioni. Kreu detyra me përgjegjësi në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Klinikën e Fizioterapisë. Mori pjesë në disa kongrese e simpoziume shkencore dhe publikoi punime shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Vjollca Mekaj)

HURUGLICA Ali (1930-1996). Shkrimtar për fëmijë. Lindi në fshatin Gjyrishec të Kamenicës. Kreu shkollën fillore në Prishtinë, kurse disa klasë të mesme i mbaroi në Gjilan. Punoi si mësues në Ramjan, 24 vjet rresht. Ndërkohë mbaroi edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Punoi edhe në revistat “Gëzimi” e “Fatosi” në Shkup, ndërsa deri në pensionim punoi në Bibliotekën Rajonale “Fan Noli” në



ALI HURUGLICA

Gjilan. Botoi kryesisht përmbledhje me poezi për fëmijë, por edhe proza të shkurtra. Motive të poezisë së tij janë fëmijëria, shkolla, vendlindja, loja e fëmijëve, raporti midis fëmijëve dhe prindërve, por edhe jeta interesante e cergarëve, duke u përpjekur të mos harrojë asgjë nga ato që kanë mbetur të ngulitura në shpirtin e tij. Është përfaqësuar në antologji dhe panorama të poezisë sonë për fëmijë. Veprat e botuara: “Zani i zamares” (1964), “Kaçuba” (1966), “Ylli më ka tregue” (1967), “Kangët e plakut me lahutë” (1968), “Pulëbardha” (1968), “Shkurtabiqi zemërtartë” (1968), “Zogu i bardhë” (1969), “Xhita me yll” (1969), “Bilbili i gëzimit” (1971), “Kthimi në fëmijëri” (1971), “Qershia me çadër” (1973), “Princi i tëndafilave” (1977), “Dreri në mal” (zgjedhje, 1969), “Jastëku i ëndrrave” (1996), “Duar të bardha”, 2002 etj. (Xhevat Sylja)

HUSAJ Gazmend (1987-). Volejbollist. Që nga mosha 14-vjeçare u inkuadrua në klubin e volejbollit “Rugova”, duke vazhduar më pas në “Mabetex” të Prishtinës, ku qëndroi për dy stinorë dhe fitoi dy herë titullin dhe Kupën e Kosovës. Më pas kaloi te klubi “Studenti” i Tiranës, klub me të cilin fitoi dy herë titullin dhe Kupën e Shqipërisë. Që nga viti 2006 u bë pjesë e kombëtares së Shqipërisë në volejball. Më 2008, në kualifikimet për Kampionatin European të mbajtur në Azerbajxhan, u shpall

lojtari më i mirë i kualifikimeve. Pastaj kaloi te “Chenois Volley” të Gjenevës, më pas bëhet pjesë e klubit “Muharraq” të Bahreinit, kurse në stinorin tjetër te “Shkëndija” e Tetovës, duke i sjellë klubit për herë të parë titullin e kampionit dhe Kupën e Maqedonisë. Nga viti 2011 deri në vitin 2013 ishte pjesë e “Qatar Sports Club”, ku dy herë radhazi u shpall lojtari më i mirë i kampionatit. Më pas kaloi te skuadra italiane “Kopra Elior Piacenza”, me të cilën u bë pjesëmarrës në garat e ligës së kampionëve. Ishte nënkampion i Serisë A1 dhe fitues i Kupës së Italisë për stinorin 2013/14. Që nga viti 2014 është pjesë e ligës turke, me klubin “Mili Piango” të Ankarasë. (Ejup Llumnica)

HVOSNA. Njësi administrative nga fundi i shek. XII, që përfshinte qytetet e sotme të Pejës dhe të Istogut, me disa katunde përreth tyre. Hapësira e Kosovës së sotme dhe popullsia e saj ishte së paku deri në vitin 1198 nën sovranitetin kishtar e administrativ të Perandorisë së Bizantit. Edhe vetë burimet cirilike e cilësonin këtë hapësirë si “tokë greke”. Si rezultat i pushtimeve dhe i ngulimeve të vazhdueshme pas shek. XII, ardhësit rasianë krijuan njësi të vogla territoriale, që në terminologjinë e tyre historiografike quhen *zhupa*. Ato u krijuan kryesisht përreth qyteteve e fortifikatave, të cilat sllavët i gjetën aty kur u dyndën. Njëra ndër to ishte edhe Hvosna. Merret e sigurt se Hvosnës i takonin, midis të tjerash, Peja dhe katundet e sotme Carravër, Shtupel, Treboviq, Gorazhdë, Çellopek, Llabjan e Lutogllavë të rrethinës së saj, bashkë me ndonjë katund në Bjeshkët e Nemuna, të cilat sundimtari rasian ia falte në vitin 1220 Manastirit në themelim të Zhicës. Mendohet se qendër e zhupës kishte qenë Lutogllava, ose vendbanimi i sotëm Dërsnik i Klinës, i mbajtur për qytet, i cili përmendet që në gjysmën e shek. X në veprën e Constantine Porphyroenitos “Mbi administrimin e Perandorisë së Bizantit”. Mendohet se Hvosno është quajtur ose sipas një qyteti parabizantin, *Hosnon* (të padëshmuar në burime shkrimore), ose nga një fjalë sllave e vjetër, e cila është ruajtur vetëm në çekishten si *hvosna* dhe ka kuptimin lisnajë, dushkajë ose mal i shpeshtë. Ky emër gjalloi vetëm në ndonjë shkrim kishtar serb. (Skënder Gashi)

HYJNESHA DARDANE. Hyjneshë në krye të panteonit dardan. Ishte personifikim i diellit




HYJNESHA DARDANE

nga faza antropomorfe e besimit politeist (shek. IV p.e.r.) dhe në monumentet epigrafike të periudhës romake paraqitet me nocionin latin: Dea Dardanicae. Ishte hy autokton i fazave të ndryshme të besimit dardan dhe si hy sinkretik përmban një shumësi simbolesh: edhin, cjapin, diellin, gjysmëhënën, sëpatën, viçin, këndesin, altarin, derrin faran, lerthin, spiralen, kallirin e grurit, hardhinë e rrushit, shportën e bollëkut, svastikën, qesen, kurorën e qytetit, një profalktike dhe labirintin. Fitoi pozitë supreme në panteonin dardan, si hy i diellit dhe i rendit kozmik. Ishte psikopomp mortal dhe zuri aspektet transendentale, duke sjellë dhe njohuritë kozmologjike dhe kozmogonike dardane.

Në monumentet e Hyjneshës Dardane paraqitet koncepti i treshit, i cili shfaq formulën e krijimit të tri botëve të paramenduara dardane: tokësore, të nëndheshme dhe qiellore. Monumentet gurore kushtuar hyjneshës datojnë vetëm nga periudha romake (shek. II-III) dhe kanë skemë ikonografike që shpreh frymë vendore dhe të afërt me ndikimet helenistike. Besimi në të si bartëse e identitetit dardan u rifuqizua gjatë periudhës romake dhe krijoi bazë për përfaqimin e monoteizmit të krishterë. U njoh përmes monumenteve të periudhës romake nga Romula Malva në Rumani; Smira, Gllamniku dhe monedhat e Soçanicës në Kosovë, si dhe nga Mediana, Branetiqi i Poshtëm dhe Kamenica në Serbi. (Edi Shukriu)

HYJNESHA E VAROSHIT. Figurinë femre e epokës së neolitit të hershëm, e punuar nga argjila e kuqe. U gjet rastësisht në vendbanimin neolitik në fshatin Varosh, pranë Ferizajt. Figurina ka trajtë të shtyllëzës së zgjatur, me duar të paformuara mirë dhe gjinj të theksuar (8 cm). Sytë janë dhënë me dy vija paralele horizontale dhe ka hundë të drejtë e të zgjatur në maje. Flokët e trajtësuar me vija të thelluara ia mbulojnë pjesën e sipërme të kokës dhe i bien mbi shpinë. Veshët janë paraqitur anash fytyrës më anë të dy shtesave konike. Paraqitja e gjinjve të theksuar e personifikon si hyjneshë të pjellorisë të mijëvjeçarit V p.e.r. (Haxhi Mehmetaj)

HYJNESHA NË FRON. Idhull parahistorik prej argjile të pjekur. U zbulua në lokalitetin Tjerrtorja në Prishtinë. Ka gjatësi prej 18.5 cm dhe i takon kulturës së Vinçës të epokës



HYJNESHA NË FRON

së eneolitit. Është shprehje e figurës së Magna Mater dhe po aq e dualizmit gjinor, si shkallë më e lartë e përfytyrimit të hyjve paganë. Paraqitja e dualizmit gjinor, si fazë më e avancuar e besimit, zhvillohet nga epoka e eneolitit të hershëm, me nismën e veprimtarive xehetare (para dyndjeve indoeuropiane). Ky dualizëm gjinor shquhet më së shumti përmes kësaj figurine, në të cilën mungojnë gjinjtë dhe në barkun e fryrë gjendet labirinti i gërvishtur, si simbol i mitrës dhe qendër e krijimit të jetës. Shquhet edhe qaforja me

medaljon rrethor solar, e cila paraqitet edhe te idhujt e ulur të Barilevës, Fafosit të Mitrovicës, Bardhoshit, Vinçës etj. Qaforet me medaljon solar duken kryesisht vetëm te hyjtë e ulur, të cilët kishin pozitë dominuese mbi hyjtë e tjerë. Labirinti, si qendër e krijimit të jetës dhe medaljoni solar ndërlidhen me diellin e plotfuqishëm. Medaljoni solar paraqitet si element ikonografik edhe në monumentet e Hyjneshës Dardane të periudhës romake, si simbol identifikues i kultit të diellit dhe vijimësi e identitetit mijëvjeçar që shpreh dhe fuqinë kozmogonike diellore. (Edi Shukriu)

HYSA Bedri (1935-2013). Poet. Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Kaçanik dhe Mitrovicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në fillim punoi si arsimtar në disa shkolla të Kosovës. Ishte drejtor i gjimnazit në Kaçanik, pastaj sekretar në Bashkësinë Krahinore të Kulturës dhe më pas për shumë vjet drejtor i Bibliotekës Popullore dhe Universitare të Kosovës, më vonë Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Ka botuar kryesisht vepra me poezi, ndër të cilat: “Duke kërkuar njerinë” (1973), “Pikë e pesë” (1987), “Kohë Kosove” (1991), “Këtu është Troja” (1994), “Në mes fjala e bekuar” (2000), “Shoka e ylberit” (2012) etj. Në fushën e publicistikës e ka botuar veprën “Tempulli i librit” (2009), në të cilin trajtohen tema që i përkasin veprimtarisë bibliotekare dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me librin në përgjithësi. Poezitë e B. Hysës janë të shumëllojshme dhe ndërtohen me figuracion të pasur. (Sali Bashota)

HYSA Mahmud (1934-2016). Studiues i letërsisë, profesor. Lindi në Dibër (Maqedoni). Kreu shkollën fillore në vendlindje, tetëvjeçaren në Tiranë, Normalen në Tetovë, ndërsa studimet



MAHMUD HYSA

për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik në Beograd. Në Dibër ishte profesor i gjuhës shqipe në gjimnaz, një kohë punoi në Akademinë Pedagogjike në Shkup, ndërsa nga viti 1974 ligjëroi në Fakultetin Filologjik në Prishtinë. Në Universitetin e Prishtinës u doktorua me temën “Andon Zako-Çajupi, jeta dhe vepra” në

vitin 1980. Ishte ndër profesorët e parë të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Është marrë me studime për letërsinë e vjetër shqipe, alhamiadon, dhe trashëgiminë letrare të arbëreshëve të Italisë. Ka përgatitur për shtyp kompletin e A. Z. Çajupit të “Rilindja”. Ka botuar këta libra: “Letrari dhe vepra” (1972), “Gjurmëve të letërsisë arbëreshe (1978), “Andon Zako-Çajupi, Jeta dhe vepra” (1983), “Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare” (1986), “Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqipe” I dhe II (1995-1996), “Said Najdeni - Hoxhë Voka” (1996), “Alamiada shqiptare” I dhe II (2000), “Hyrje në letërsinë shqipe” (2000), “Një Kosovë e vogël në Dibër të madhe” (1999), “Bogdani, si nuk e njohim”.(2008) si dhe veprat e përmbledhura në “Studime” I (Tema nga letërsia shqiptare), II (Tema për historinë kombëtare), III (Qasje veprave të pesë studiuesve shkodranë), IV, V (Polifonia e tekstit letrar – Fiksioni në romanet e Ibrahim Kadriut) dhe VI (Said Najdeni - Hoxhë Voka dhe Hafiz Sherif Langu) etj. Është dhe autor i teksteve shkollore dhe laureat i disa çmimeve të rëndësishme. (Ali Aliu)

HYSA Ylber (1965). Gazetar dhe diplomat. Lindi në Shkup. Shkollimin fillor, të mesëm dhe studimet për histori i mbaroi në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në departamentin e historisë në Universitetin e Europës Qendrore në Budapest. Gjatë viteve '90 punoi në gazetën “Fjala”, kryesisht në redaksinë e kulturës dhe bashkëpunoi me revistën “Zëri”. Nga viti 1991 e deri në vitin 1997 ishte redaktor dhe bashkëthemelues i të përjavshmes “Koha” dhe më pas i gazetës së përditshme “Koha ditore”. Nga viti 1997 deri në vitin 2004 ishte drejtor i institutit KACI (Kosovo Action for Civic Initiatives), ndërsa nga vitit 2004 deri më 2007 ishte deputet i Parlamentit të Kosovës nga radhët e partisë “Ora”. Gjatë negociatave për statusin e Kosovës ishte pjesë e ekipit negociator, përkatësisht bashkëkryesues i grupit për trashëgiminë kulturore. Nga viti 2012 është ambasador i Kosovës në Republikën e Maqedonisë në Shkup. (Besim Abazi)

HYSAJ Fadil (1953-). Regjisor, dramaturg, mësimdhënës universitar. Lindi në Shtime, ku kreu shkollimin fillor. Mbaroi gjimnazin në Ferizaj, ndërsa aktrimin në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1974). Studimet e teatrologjisë dhe letërsisë krahasimtare i mbaroi në



FADIL HYSAJ

Universitetin e Sarajevës (1978), ku paralelisht mbaroi edhe studimet e regjisë teatrore (1979). Që në fillim të viteve '70 u paraqit si regjisor i teatrit me disa shfaqje: “Ngjarja në Vishi”, me cilën në Festivalin Jugosllav në Trebinjë fitoi çmimin për regjinë më të mirë (1975), pastaj “Tregimi ynë zoologjik”, “Raketat e bardha fluturojnë për Amsterdam”. Më pas, gjatë viteve '80 renditen një numër shfaqjesh të inskenuara në Teatrin Popullor Krahinor, në Teatrin e Gjakovës dhe në Teatrin e Kombësive në Shkup, kryesisht me drama të autorëve shqiptarë, si: “Roja e shiut”, “No pasaran”, “Zeka i zi udhëton për në Babilon”, “Unë Halil Garria”, “Ora e kukuvajkës”, “Beselam pse më flijojnë”, “Hëna prej letre”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit” etj. Në vitet '90 të shekullit të kaluar, krahas aktivitetit të tij si regjisor teatri, F. Hysaj paraqitet edhe si dramaturg, me inskenimin e veprave të tij autoriale dhe dramatizime të ndryshme, si: “Dante 9” (1995) në Teatrin “Dodona”, “Kali i Trojës” dhe “Balada e urtisë” (1997) në Teatrin Shqiptar në Shkup, si dhe më pas “Shfaqja e fundit” (2001) në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Në mesin e shfaqjeve, të cilat shquhen me avancimin e mëtejme të prirjeve eksperimentale dhe të mesazheve artistike do theksuar trilogjia “Orestia” të Eskilit (2003) dhe “Mbreti Lir” (2005). Njëra nga shfaqjet e tij më të shpërblyera, me të cilën shënon një kthesë të re në poetikën e tij regjisoriale është “Shtëpia në ankand” (2012), e cila u shpërblye në disa festivale, si në Podujevë, Dibër, Gjilan etj., përfshirë edhe çmimin vjetor të Ministrisë së Kulturës të Kosovës për regjinë më të mirë për vitin 2013. Gjithashtu është autor i skenarëve të filmave “Njeriu prej dheu”, “Rojet e mjegullës”, “Syni i keq”. Shkroi edhe ese dhe analiza mbi çështjet e teatrit, të dramës dhe të filmit, të botuara nëpër gazetatat dhe revistat tona, si dhe i përmbledhjes me shkrime të përkthyer “Teatrologji, dramaturgjia, regji dhe aktrim” (2006). Paralelisht me punën e tij si profesor në Fakultetin e Arteve, ku e ligjëron lëndën e regjisë së teatrit, në vitin 2010, në fshatin Kukaj themeloi “Etno Teatrin” dhe më pas festivalin “Etno Fest”, me një sërë programesh artistike dhe kulturore të traditës. Është bartës i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve. (Besim Rexhaj)

HYSAJ Fahri (1956-2011). Regjisor filmi, mësimdhënës universiteti. Lindi në Shtime. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë për Teatër, Film dhe Televizion e kreu në Universitetin e Zagrebit. Gjatë studimeve në kuadër të Televizionit të Prishtinës bëri regjinë e tre dokumentarëve për Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin. Në atë periudhë realizoi filmin dokumentar për Mitrovicën “Zogjtë më nuk vijnë këtu”. Është autor i shumë programeve televizive të të gjitha zhanreve. Punoi në programin artistik e dokumentar të Televizionit të Prishtinës (TVP). Një kohë ishte përgjegjës artistik i programeve satelitore të Televizionit Shqiptar. Ishte mësimdhënës në degën e artit dramatik të Universitetit të Tetovës, ku ligjëroi lëndën historia e filmit dhe aktrimi intermedial. Në Fakultetin e Arteve në Prishtinë ishte pedagog i filmit dokumentar. Mori çmimin e parë të Ministrisë së Kulturës së Kosovës në vitin 2004 për skenarin e filmit dokumentar “Tri vrasje në derë të shtëpisë”. Filmi dokumentar “Fytyrë dheu” për piktorin Adem Kastrati, i prodhuar nga “Kosovafilmi”, është filmi i tij më i realizuar. Po ashtu bëri filmat dokumentarë për personalitete të kulturës e të jetës publike si: “Esat Mekuli”, “Atë Gjergj Fishta”, “Faik Konica”, “Idriz Ajeti”, “Nëna Ajshe”, “Gjurmë të humbura” dhe “Vetmia”. Ndërkaq, realizoi edhe edhe filmat e metrazhit të shkurtër “E shtëna në borë” dhe “Kaçarreli”. Bashkëpunoi në realizimin e filmit dokumentar për Nënë Terezën, “Një rrëfim për nënën”. (Gani Mehmetaj)

HYSAJ Neritan (1987-). Pianist. Kreu studimet për piano në Universitetin e Prishtinës në klasën e prof. V. Petrovcit. Më 2002 u shpërblye me çmimin e tretë në Festivalin “Pianisti i ri” në Tiranë. Ka performuar si solist dhe shoqërues pianistik për performues të tjerë. Paraqitjen më të suksesshme si solist e kishte me Filharmoninë e Kosovës (2009) me koncertin për piano e orkestër të E. Grieg-ut. Aktualisht vijon karrierën pianistike si solist dhe me ansamble të ndryshme. Nga viti 2013 vijoi studimet në drejtimin e pedagogjisë së instrumenteve dhe të këndimit në BTU Cottbus-Seftenberg për piano me prof. Wolfgang Glemser në Gjermani. Është ndër protagonistët e filmit dokumentar të regjisorit gjerman Walter Wehmeyer “Muzika pas luftës – Kosova në mes traumës dhe rifillimit”. (Besa Luzha)

HYSAJ Ujkan (1984-). Regjisor, producent. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet për regji filmi i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Si regjisor dhe producent deri tani punoi filma të shkurtër dhe dokumentarë: “Lojëra të vjetra teatrore (2002), “Menuet për Maksutin dhe Fetahun” (2003), “Kaona” (2004), “Windows XP” (2005), “Bathhtub” (2006), “Kolona” (2012), “Fjala e dhënë” (2016) etj. Me filmin e shkurtër “Kolona” mori pjesë në një sërë festivalesh prestigjioze dhe mori një sërë çmimesh ndërkombëtare, si dhe çmimin e publikut në Festivalin “DokuFest” në Prizren dhe i çmimit vjetor për kinematografi “Bekim Fehmiu” (2013), që ndahet nga Ministria e Kulturës e Kosovës. (Emin Emini)

HYSEINI Halil (1948-2010). Gazetar, spiker. Lindi në Frangovë të Strugës. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje dhe në Strugë, ndërsa Fakultetin e Filozofisë e mbaroi në Shkup. Punoi në Tetarin e Kombësive të Shkupit, kurse që nga viti 1977 ishte moderator, gazetar dhe redaktor në redaksinë e politikës së jashtme të Radiotelevizionit të Prishtinës deri në mbyllje nga Serbia më 1990. Më pas punoi në Radion “Europa e lirë” në Pragë, kurse ishte edhe zëdhënës i komunës së Strugës. H. Hyseini u mor edhe me skulpturë dhe me poezi. Më 2005 botoi përmbledhjen me poezi “Rrëmujë dhe paqe”. (Shaqir Foniqi)

HYSENAJ Haki (1958-). Gjuhëtar. Lindi në Lëbushë të Deçanit. Studimet për gjuhë dhe letërsi i kreu në Prishtinë. Specializoi për fonetikë të zbatuar dhe eksperimentale në Institutin e Fonetikës të Universitetit të Zagrebit. Më 1993 kreu studimet pasuniversitare, ndërsa tezën e disertacionit të doktoratës për gjuhën në veprën e Ernest Koliqit e mbrojti në vitin 2009. Një kohë punoi si gazetar në “Rilindje”, ndërsa nga viti 1983 deri në vitin 1997 ishte asistent në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, pastaj ligjërues për lëndën gjuhë e sotme shqipe (1997-2010) dhe më pas profesor asistent në degën e gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore dhe botoi studime në fusha të ndryshme të gjuhësisë, dialektologji, studime për gjuhën letrare, si dhe shkrime letrare e publicistike. (Bardh Rugova)

HYSENI Agim (1957-). Sociolog, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Kreu studimet për sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit



AGIM HYSENI

të Prishtinës (UP). Punën në UP e filloi në vitin 1979 si asistent dhe nga viti 1991 është profesor i sociologjisë. Kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit, ndërsa u doktorua më 1987 në Fakultetin Filozofik të UP-së. Fushat

kryesore shkencore në të cilat është i përqendruar në mësimdhënie dhe hulumtime janë teoritë sociologjike, sociologjia politike dhe sociologjia e arsimit. Ka qenë bashkëthemelues dhe udhëheqës i Sindikatës së Arsimit, SBASHK (1989-2001). Ishte njëri nga udhëheqësit e organizimit të shkollave në kampet e refugjatëve kosovarë më 1999 në Shqipëri dhe Maqedoni. Në vitin 2005 mori pjesë në një program studimi në Universitetin e Pitsburgut, SHBA. Ushtrio edhe detyra të tjera më përgjegjësi në institucionet e arsimit. (Mentor Agani)

HYSENI Halim (1944-). Veprimtar dhe ekspert i arsimit. Lindi në Kapit, komuna e Medvegjës, ku kreu edhe shkollën fillore. Arsimin e mesëm e mori në Normalen e Prishtinës.



HALIM HYSENI

Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua më 1970. Fillimisht ishte mësues në vendlindje, përkatësisht në Lajthishtë (Leshkoshiq) të Obiliqit, pastaj mësimdhënës i lëndëve pedagogjike në Normalen e Ferizajt, pedag

ogj shkollë në shkollën teknike po në Ferizaj, këshilltar dhe zëvendës drejtor në Entin për Përparimin e Edukimit dhe të Arsimit në Prishtinë. Ishte drejtor i Entit Krahinor për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit (1987-1990), përkatësisht i Entit Pedagogjik të Republikës së Kosovës (1990-1996), titullar në Ministrinë e Arsimit etj. Punoi për organizimin e mësimin në shtëpi-shkollë, në rrethana të jashtëzakonshme (1991-1999). Është autor i publikimeve profesionale arsimore në revista dhe gazeta të ndryshme dhe autor i veprave po nga kjo fushë: “E vërteta për

helmimet” (1995) dhe “Qeverisja dhe udhëheqja në arsim” (2006), si dhe bashkautor i disa të tjerave: “Arsimi në Kosovë (shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës)” (2000), “Disa aspekte të efikasitetit të arsimit në Kosovë” (2002), “Barazia gjinore në librat e leximit të arsimit të detyruar nëntëvjeçar” (2007), “Korniza e kurikulës të edukimit multikulturor” (2001), “Parandalimi i dhunës në shkollë” (2011) etj. (Demë Hoti)

HYSENI Hydajet (1954-). Veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Përlepnice të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Gjilan (1972). Studioi në Fakultetin



HYDAJET HYSENI

Juridik dhe Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1974-78) dhe punoi si gazetar në të përditshmen “Rilindja” (1976-1978). Si anëtar i oranzatës Lëvizja për Republikën e Kosovës (LPRK), nga prilli i vitit 1978 deri në dhjetor të vitit 1981 jetoi

në ilegalitet, kur u burgos dhe u dënua me 15 vjet burg. Pas daljes nga burgu në fillim të viteve '90, së pari u përfshi në aktivitetin e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ) dhe më pas (1994) u angazhua në strukturat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, një mandat edhe nënkryetar i saj (1994-1998). Më 1992 u zgjodh deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, ndërsa pas vitit 1998 sekretar për marrëdhënie me jashtë i Lëvizjes së Bashkuar Demokratike dhe pjesëmarrës i Konferencës së Rambujesë. Pas luftës ishte deputet i Parlamentit të Kosovës në disa legjislatura. Nga viti 2008 drejtoi edhe Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, duke u rizgjedhur në krye të saj edhe në vitin 2015, ndërsa nga vitit 2014 është kryesues i Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Ka botua shkrime të shumta letrare dhe publicistike në shtypin e kohës. Është autor i disa botimeve, ndër të cilat i poemës “Pushka amanet” (1989), “Këngët e lirisë” (1980), i albumit poetik “Pranverë në katër pamje” (2006), i veprave për fëmijë “Përrallat flasin në gjuhën time” (1984) dhe i poemës “Batakçi në batak” etj. (Fehmi Rexhepi)

HYSENI Nexhmedin (1956-). Mjek, kirurg i fëmijëve, profesor universiteti. Lindi në

Brezne të Dragashit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prizren dhe Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1981). Kreu specializimin për kirurgji të fëmijëve në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ku i mbaroi edhe studimet pasuniversitare, ndërsa studimet e magjistraturës dhe të doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1997). Një kohë punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prizren, më pas kaloi në repartin e kirurgjisë së fëmijëve në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Pas përjashtimit nga puna më 1990 nga administratat e dhunshme serbe, vazhdoi profesionin e kirurgut të fëmijëve në poliklinikën private në Prizren. Është profesor i rregullt i lëndës kirurgjia e fëmijëve në Fakultetin e Mjekësisë, pastaj drejtor i Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve dhe anëtar i disa bordeve profesionale dhe shkencore. Mori pjesë në disa kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Avdyl Krasniqi)

HYSENI Qazim (1957-). Mjek, specialist i otorinolaringologjisë, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kostërc të Skënderajt. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Skënderaj, ndërsa studimet në Fakultetin e Mjekësisë të UP-së (1981). Pas diplomimit punoi në vendlindje deri më 1983, kur u punësua dhe filloi specializimin në Klinikën e Otorinolaringologjisë (ORL) në Prishtinë. Specializoi në Zagreb, ku kreu subspecializimin nga audiologjia me vestibulogji. Në të njëjtën kohë vijoi studimet pasuniversitare edhe në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës mbrojtë temën e magjistraturës dhe në vitin 1996 tezën e doktoratës. Më 1989 u zgjodh asistent dhe më 1997 docent i lëndës së otorinolaringologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Është profesor ordinar i ORL-së. Nga viti 2007, një mandat ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë. Ka marrë pjesë në disa kongrese e simpoziume dhe ka publikuar disa punime shkencore. (Refik Ramku)

HYSENI Rrustem (1973-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Gumnishtë të Shalës së Bajgorës, komuna e Vushtrrisë. Studimet për histori i filloi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte kryetar i

Unionit të Pavarur të Studentëve në Fakultetin Filozofik dhe njëri nga organizatorët e protestës studentore më 1 tetor 1997. Mori pjesë në demonstratën e 2 marsit 1998. Më 5 korrik 1998 iu bashkëngjiti radhëve të UÇK-së në Shalën e Bajgorës. Së pari u vendos në fshatin Zabërgjë, pastaj u transferua në njësitin e Kaçandollit. U plagos në betejën Mazhiqit më 15 shtator 1998. Në periudhën shtator-tetor 1998 shërbeu në komandën e Brigadës 141 "Mehë Uka". Me formimin e njësisë speciale, u inkuadrua në kompaninë e dytë të kësaj njësie. Gjatë periudhës shkurt-mars 1999 mori pjesë në luftimet që u zhvilluan në Ashlan, Liqe, Vaganicë, Bukosh, në betejën e Trepçalivë dhe të Majdanit. Ra heroikisht më 26 prill 1999 në Kodrën e Majdanit të Shalës së Bajgorës. (Miftar Kurti)

HYSENI Sevdail (1959-). Gazetar. Lindi në Priboc të Bujanocit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Bujanoc, studimet për letërsi në Prishtinë. Me gazetari merret që nga viti 1990. Ishte kryeredaktor i revistës "Jehona" (1992-2002), pastaj korrespondent i gazetës "Kosova sot" (1998-2000), korrespondent i gazetës "Bota sot" (2000-2002), bashkëpunëtor i revistës mujore "Ekskluzive" etj. Në periudhën 2002-2006 u zgjodh kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanocit. Nga viti 2009 është drejtor i Radiotelevizionit të Bujanocit. Është autor librash me poezi, me aforizma, intervista dhe përmbledhesh me shkrime publicistike. Për poezinë satirike "Me shajkaçe në Evropë" të librit "Kur të qeshë fati", botuar në edicion të revistës "Fjala" më 1994, u nxor në gjyq 28 herë, për 5 vjet rresht, dhe në fund u shpall i pafajshëm. (Zija Rexhepi)

HYSENI Xhemajl (1920-2004). Mjek, specialist i mjekësisë interne. Lindi në Vranishtë, komuna e Dragashit. Kreu Fakultetin e Mjekësisë dhe specializimin për mjekësi interne në Universitetin e Beogradit (1951). U punësua në Spitalin e Gjakovës, ndërsa në Spitalin e Prizrenit punoi nga viti 1961 deri në vitin 1986, kur edhe u pensionua. Me emrin e tij është i lidhur ngushtë zhvillimi i shërbimit internistik në Kosovë. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave për përkushtimin profesional dhe kontributin e dhënë në fushën e mjekësisë. (Ymer Elezi)

I

IBËRDEMAJ Nazmi (1952-). Karateist. Lindi në fshatin Shtupeq i Vogël në Rugovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërkaq shkollën e mesme dhe shkollën e lartë të telekomunikacionit në Beograd. Fakultetin Juridik e kreu në Prishtinë. Sportin e karatesë filloi ta ushtronte në mënyrë individuale, ndërsa më vonë u bë ndihmëstrajner në Klubin e karatesë “Partizani” në Pejë. Ishte tetë herë kampion i Kosovës në kategorinë absolute, fitues i shumë turneve vendore dhe ndërkombëtare, në vitin 1980 u shpall nënkampion i ish-Jugosllavisë. Ishte anëtar i përfaqësueses së seniorëve të ish-Jugosllavisë. Karrierën aktive e përfundoi në vitin 1982 për të vazhduar si trajner në KK “Partizani” dhe më pas në KK “Ippon”. Nxënësit e tij morën medalje në të gjitha kampionatet vendore, ballkanike, europiane dhe botërore. Në vitin 2002 iu shtrua provimit për shkallën e gjashtë ROKU DAN, me çrast mori titullin e lartë SHIHAN. Titullin e gjyqtarit federativ e arriti në vitin 1982. Në vitin 1989 bëhet gjyqtari i parë ndërkombëtar shqiptar. Në Kampionatin Botëror në Karate të WSKU-së në vitin 2004 në Tokio u shpall gjyqtari më i mirë. (Rifat Gjonbalaj)

IBISHI Fatmir (1964-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në fshatin Uglar, komuna e Gjilanit. Në fillim të vitit 1990 emigroi jashtë vendit, por u kthye në Kosovë në prag të luftës së UÇK-së. Në mars të vitit 1999 iu bashkua Zonës Operative të Karadakut, në njësitin vëzhgues-diversant të Uglarit. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, vazhdoi aktivitetin si pjesëtar i njësiteve të para të UÇPMB-së. Kreu disa aksione kundër

forcave serbe. Më 26 shkurt 2000, në aksionin e zhvilluar në mes të Konçulit dhe postbllokut policor serb, u vra gjatë luftimeve. (Fehari Ramadani)

IBISHI Ibrahim (1953-2010). Shkrimtar. Lindi në fshatin Kremenatë të Kamenicës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike i mbaroi në Gjilan. Një kohë punoi si mësues në vendlindje dhe më vonë në shkollën fillore të Ajvalisë. Shkroi poezi, tregime, novela, romane, kritika dhe botoi një sërë veprash letrare nga këto fusha të krijimtarisë. Ndër veprat e botuara tërheqin vëmendjen librat: “Shiu për kërpudhë” (1996), “Korbat mbi muranë” (1996), “Shtjella e vetmisë” (2000). Si në poezi, ashtu dhe në prozë I. Ibishi ishte një zë që imponohej me mënyrën e të shkruarit dhe të trajtimit që u bënte fenomeneve të ndryshme të hapësirës ku jetonte. (Hasan Hasani)

IBISHI Lulzim (1965-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB). Lindi në fshatin Norçë të komunës së Preshevës. Në vitin 1998 ra në kontakt me pjesëtarët e UÇK-së dhe u përfshi në radhët e saj. Veptoi në njësitet logjistike. Pas përfundimit të luftës së UÇK-së, u angazhua në organizimin e UÇPMB-së, ku u ngarkua me detyrën e komandantit të Brigadës 113 “Ibrahim Fejzullahu”, e cila vepronte në Zonën Operative të Preshevës. Udhëhoqi me sukses aksionin kundër pikës ushtarake serbe, e cila ishte stacionuar në shkollën fillore të Caravajkës. (Fehari Ramadani)

IBISHI Nuredin (1956-). Ushtarak, pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Kalaticë të Podujevës. Kreu

Shkollën e Mesme të Policisë në Vushtrri, ndërsa në vitin 1975 kreu Akademinë Ushtarake në Beograd. Kreu detyra të ndryshme në policinë e Kosovës dhe në ish-Jugosllavi. Në vitin 1994 u burgos, me pretekstin se ishte pjesëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Gjatë viteve 1998-1999 mori pjesë në luftën e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, ku ishte i njohur me nofken "Komandant Leka". Në korrik të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës I të UÇK-së në këtë Zonë, detyrë që e kreu deri në dhjetor 1998, kur u emërua shef i shtabit të Zonës Operative të Llapit. Këtë funksion e mbajti deri në demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së në shtator të vitit 1999. Pas përfundimit të luftës shërbeu në Policinë e Kosovës dhe më pas u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. (Ismet Cakiqi)

IBRA Ali (1835-1900). Njëri ndër organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të ushtrisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, prijës i Gashit. Lindi në Shipshan të Malësisë së Gjakovës. Mori pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm dhe anëtar i Qeverisë së Përkohshme. Ishte përfaqësues i rrymës radikale, krahas Y. Prizrenit, A. Frashërit, S. Vokshit, Sh. Spahiut. Nuk e nënshkroi Kararnamenë. Ishte zëvendëskomandant i përgjithshëm i ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit dhe pjesëmarrës në luftën për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë, në vitin 1880 (Velikë) dhe në betejat për çlirimin e vilajetit të Kosovës, në vitin 1881. Në vitin 1885 drejtoi aksionin për lirin e Sulejman Vokshit. Ishte i njohur për pajtim gjaqesh dhe shuarje të konflikteve fetare. Mbrojti të krishterët e Gjakovës (fandët e Mirditës) në vitet 1878-1879. (Islam Lauka)

IBRA Vanda (1957-). Balerinë nga Britania e Madhe. Lindi në Bermingam. Në vitet '70 u bashkua trupës së baletit në kuadër të Teatrit Popullor të Kosovës (TPK) dhe interpretoi në disa shfaqje të këtij baleti. Rolet më të rëndësishme: Mirusha në "Sokoli dhe Mirusha" të kompozitorit A. Koci (1976); Motra në "Kënga e Rexhës" po të A. Kocit (1983), Vasha në "Legjenda mbi ngadhënjimin" të kompozitorit R. Mulliqi (1981) etj. (Arian Krasniqi)

IBRAHIMI Idriz (1936-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Plemetin, komuna e Obiliqit, ku kreu shkollën fillore, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Mitrovicë. Fakultetin e Makinerisë, drejtimi i termoenergjetikës, e kreu në Universitetin e Zagrebit (1963). Studimet pasdiplomike i vazhdoi në Novi-Sad. Pas diplomimit zë punë në Termocentralin "Kosova A", ku kreu detyra dhe funksione drejtuese. Për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve energjetike kreu disa specializime në SHBA, në ish-Bashkimin Sovjetik dhe në Poloni. Krahas punës në prodhim, ishte ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Prishtinë. Me hapjen e Fakultetit Teknik ligjëroi lëndën stabilimentet termoenergjetike, deri në vitin 1986. Në vitin 1982 u zgjodh sekretar për energjetikë në Këshillin Ekzekutiv të KSA të Kosovës. Në periudhën 1967-1983 ishte anëtar i bordit të Elektroekonomisë së Jugosllavisë. Mori pjesë në disa kongrese botërore për energji, si: në Moskë, Bukuresht, Detroit, Stamboll, Munihi, Nju-Delhi, Montreal etj. Ishte pjesëmarrës në disa konferenca dhe tubime shkencore për energji të mbajtura në ish-Jugosllavi dhe jashtë saj. (Fejzullah Krasniqi)

IBRAHIMI Mustafa (1967-). Gjuhëtar, albanolog. Lindi në Cërnilishtë të Prilepit, Maqedoni. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Shkup, ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti disertacionin e doktoratës për fjalët e rralla dhe frazeologjizmat nga rajoni i Prilepit dhe i Krushevës. Nga viti 2001 punon në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Është themelues i revistës "Zëri i Pelagonisë". Fushat e studimeve të tij janë dialektologjia, leksikologjia, sociolinguistika dhe etnolinguistika. Botoi libra të ndryshëm, si: "Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë" (2003), "E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës" (2005), "Mikrotoponimet e vendbanimeve shqiptare në rrethin e Prilepit, Krushevës dhe Velesit" (2010) etj. (Berton Sylejmani)

IBRAHIMI Nexhat (1959-). Studiues i fesë islame, përkthyes, ish-i burgosur politik. Lindi në fshatin Zgatar të Opojës. Shkollën fillore e kreu në Opojë e Prizren, medresenë në Prishtinë, Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë (1984). Më 1987 u punësua si sekretar i Bashkësisë Islame në Prizren. Ishte kryetar i

Shoqatës së Ulemave të Kosovës. Më 1992 u arrestua dhe u dënua me burg 8 vjet heqje lirie, në procesin e njohur si “Afera e hoxhallarëve”. Pas vuajtjes së dënimit, sërish punoi si sekretar në Bashkësinë Islame të Prizrenit. Nga viti 2008 është mësimdhënës në Medresenë e Prizrenit. Botoi një sërë veprash autoriale dhe përkthime nga fushat e ndryshme të dijes fetare. Shtëpia Botuese “Logos-A” nga Shkupi, në vitin 2009 botoi kolanën e veprave të tij në 10 vëllime. Është bartës i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Elez Ismaili)

IBRAHIMI Nijazi (1949-). Inxhinier i makinërisë, profesor universiteti. Lindi në Tërrnoc të Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Bujanoc, ndërsa studimet



NIJAZI IBRAHIMI

në Fakultetin Teknik në Prishtinë (1973). Studimet e magjistraturës i kreu në Universitetin e Beogradit, kurse disertacionin e mbrojti në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1987). Më 1973 u zgjodh asistent, pastaj ligjërues, docent, profesor inordinar dhe, së fundi, profesor ordinar (1998). Ushtrroi detyra udhëheqëse në katedra dhe degë të Fakultetit Teknik, përfshirë edhe funksionin e prodekanit dhe të dekanit të Fakultetit Teknik (1988-1989). Është autor i disa teksteve universitare (“Vizatimi teknik”, “Detalet e makinave” I, II, “Teoria e qarkullimit në komunikacion dhe kapacitetet në rrugë” etj. Përveç në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, mbajti ligjëratat edhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Për avancim shkencor dhe profesional qëndroi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Tiranës (1975), në Jashi (Rumani) dhe në Berlin. Me punime shkencore mori pjesë në simpoziume dhe konferenca të ndryshme shkencore, si dhe botoi tekste shkencore në revista profesionale. Dha kontribut edhe në realizimin e projekteve për nevoja të ndërmarrjeve ekonomike. (Musli Bajraktari)

IBRAHIMI Sami (1940-2015). Filolog, profesor i gjuhës angleze, diplomat. Lindi në Shkup, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Studioi gjuhë dhe letërsi angleze në

Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare për gjuhësi i mbaroi në Zagreb. Deri më 1974 punoi profesor në Shkollën Normale të Shkupit, e më pas (1974-1992) asistent dhe ligjërues për metodikën e mësimin të gjuhës angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Me hapjen e Universitetit të Tetovës u zgjodh profesor dhe shef i departamentit të gjuhës angleze në këtë universitet. Ka punuar edhe gazetar e redaktor i botimeve të “Flaka e vëllazërimit” në Shkup. Në vitet ’90 u zgjodh deputet në Kuvendin e Maqedonisë nga Partia për Veprim Demokratik, ndërsa më vonë për një mandat ishte ambasador i Republikës së Maqedonisë në Danimarkë. Ka botuar artikuj të ndryshëm shkencorë dhe studimin monografik të doktoratës “Ndikimi i gjuhës shqipe në turqishten e folur në Maqedoni dhe në Kosovë” (2005). Ka bërë edhe një numër përkthimesh nga anglishtja. (Bardh Rugova)

IBRAHIMI Shefqet (1940-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Vinarc të Mitrovicës. Studimet i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës (1967). Studimet pasuniversitare dhe doktoraturën i mbaroi në Fakultetin Teknik të Universitetit të Zagrebit (1987). Punoi në industrinë kimike të “Trepçës”, pastaj në Institutin e “Trepçës” në cilësinë e udhëheqësit të sektorit për atestimin e prodhimeve të “Trepçës” dhe mbrojtjen e mjedisit. Për shumë vite kishte funksione drejtuese në këtë sektor. Në vitin 2002 u zgjodh profesor i rregullt në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë. Ishte prodekan dhe dekan i këtij fakulteti në dy mandate. Udhëhoqi dhe bashkëpunoi në realizimin e shumë projekteve shkencore në fushën e minierave dhe të industrisë kimike. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Izet Zeqiri)

IBRAJ Rabije (1951-). Gazetare. Lindi në Alba të Madhe të Pejës. Pas shkollimit fillor dhe të mesëm në vendlindje, mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1977 filloi punën si gazetare në redaksinë e Radio Prishtinës dhe pastaj në Televizionin e Prishtinës, ku për shumë vjet ishte gazetare-redaktore në programin dokumentar. Ishte autore e një sërë emisionesh dokumentare me tematikë sociale. Nga viti 1994 është reportere

nga Prishtina për Radio Vatikanin, emisionin në gjuhën shqipe. Më pas punoi zyrtarë e lartë për informim në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit. (Shaqir Foniqi)

IBRI. Lumë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Burimet e Ibrit janë nga gurrat karstike në Malin e Zi, në veri të malit Hajla, në lartësi mbidetare rreth 1,360 m, në afërsi



LUMI I IBRIT NË MITROVICË

të Rozhajës. Para se të hyjë në Kosovë, Ibri rrjedh nëpër Malin e Zi dhe Serbi. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut të Ibrit është 8,060 km², ndërsa në Kosovë gjenden 3,966 km². Gjatësia e përgjithshme e lumit Ibër është 272 km, kurse nëpër Kosovë ka gjatësi prej 104 km. Në hyrje të territorit të Kosovës, në lumin Ibër është ndërtuar penda, ku është krijuar liqeni artificial (liqeni i Gazivodës ose i Ujmanit), në gjatësi prej 22 km, që gjendet në dy shtete, Kosovë dhe Serbi. Prej liqenit, Ibrë rrjedh në drejtimin veriperëndim-juglindje (Mitrovicë), me ç'rast kthehet në drejtim të veriut. Lumi Ibër ndan malin Rogozna prej Malit të Thatë, po ashtu, Rogoznën prej Kopaonikut. Ndërmjet Rogoznës dhe Kopaonikut, lumi Ibër ka krijuar një grykëluginë të ngushtë e të thellë, e cila karakterizohet me pragje të shumta, ndërsa rrjedha është e shpejtë. Gjatësia e grykës nga Mitrovica deri në të dalë në Serbi është e gjatë rreth 70 km, gjerësia 1-3 km, kurse thellësia deri në 900 m. Grykëlugina e Ibrit kalon nëpër formacione magmatike të mesozoikut, fllshit

të kretakut etj. Sasia mesatare e reshjeve në pellgun e Ibrit është 682 mm, ndërsa koeficienti i rrjedhjes 0.34. Moduli i rrjedhjes në territorin e Kosovës është mes 5-10 l/sek/km². Në hyrje të territorit të Kosovës prurja e lumit Ibër është 12.5 m³/sek, ndërsa në të dalë në Serbi (Leposaviq), prurja mesatare vjetore është 30.8 m³/sek. Rritja e prurjeve ndikohet nga derdhja e lumit Sitnica (prurja mesatare vjetore 12 m³/sek) në Mitrovicë, si dhe nga mbledhja e ujërave rrjedhëse nga pjesa veriore e Kosovës. Gjatë vitit prurja ka luhatje ndërmjet 11.2 m³/sek (shtator) deri në 50.7 m³/sek (prill). Prurja më e madhe e ujit haset në pjesën e parë të vitit, që ndërlidhet me regjimin nivalo-pluvial. Dega më e rëndësishme e Ibrit në Kosovë është Sitnica, e cila mbledh edhe ujërat e Drenicës, të Llapit dhe të disa degëve më të vogla në Fushën e Kosovës.

Në drejtim të pjesës burimore të Ibrit është ndërtuar “Magjistranja e Adriatikut”, rrugë që lidh Kosovën me detin Adriatik, ndërsa në drejtim të pjesës veriore, përgjatë luginës së Ibrit, kalon rruga automobilistike dhe hekurudhore Selanik-Mitrovicë-Beograd. Ujërat e lumit Ibër rrjedhin në drejtim të ujëmbledhësit të Detit të Zi. (Valbon Bytyçi)

IDRIZAJ Besian (1987-2010). Futbollist. Lindi në Austri, ku i filloi edhe hapat e parë të futbollit. Nisi karrierën si futbollist te skuadra “Admira Linz”. Me këtë skuadër luajti me moshat e reja deri në vitin 2003, kur iu bashkua ekipit të parë dhe nisi karrierën profesionale. Më vonë kaloi te “LASK Linz”, ku qëndroi deri në vitin 2005 para se të firmoste me “Liverpoolin”. Në edicionin 2004/05 u shpall lojtari më i mirë i ri i vitit në Austri. Pas dy vjetësh qëndrimi te “Liverpooli”, Idrizaj u huazua në kategoritë e ulëta angleze. Luajti edhe për ekipin U-21 të Austrisë, për të cilin shënoi tre gola në 12 paraqitje gjatë periudhës 2007-2009. Në vitin 2009 kaloi të ekipi i “Eilenburg-ut” ku qëndroi për pak ndeshje, para se të kthehej në Angli te skuadra “Swansea City”. Ndërroi jetë në moshën 22-vjeçare, në shtëpinë e tij në Linz të Austrisë, nga një sulm kardiak. (Tahir Sopi)

IDRIZI Arben (1974-). Poet, përkthyes letrar, publicist. Lindi në Beçiq të Vushtrrisë. Kreu shkollimin fillor në fshatin e tij të lindjes, ndërsa atë të mesëm në Vushtrri. Ndoqi studimet për letërsi shqipe në Fakultetin e

Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Botoi librat poetikë “Heqakeq” (2003) dhe “Libri i të qenit” (2009). Përktheu nga italishtja poetin italian Valerio Magrelli: “Hiçi që është nën” (2009). Gjithashtu, përktheu dhe botoi edhe poetë të tjerë e kantautorë italianë, mes të cilëve: Eugenio Montale, Cesare Pavese, Mario Luzi, Pier Paolo Pasolini, Alda Merini, Flavio Santi, Fabrizio De Andre, Francesco Guccini, Franco Battiato dhe Edoardo Sanguineti etj. Disa nga poezitë e tij janë përkthyer në gjuhë të huaj dhe janë pjesë e antologjive të ndryshme poetike. Është bashkëpunëtor i revistës letrare “MM” dhe punon në portalin “Gazeta Express”. (Agron Gashi)

IDRIZI Enver (1966-). Karateist, kikboksier. Lindi në Shkup. Ishte anëtar i përfaqësueses së Kroacisë dhe u bë kampion i Jugosllavisë në moshën 16-vjeçare dhe më pas kampion bote. Nga viti 1992 e deri më 1995 E. Idrizi fitoi një medalje në Kampionatin Botëror në kategorinë absolute, dy medalje të argjendta dhe një të bronzitë, kurse në kampionate europiane fitoi dy medalje të arta në kategorinë e rëndë dhe dy medalje të argjendta. E. Idrizi fitoi medaljen e parë të artë me Kroacinë në datën e njohjes ndërkombëtare të këtij shteti, në Botërorin e mbajtur në Milano të Italisë. Në Kupën e Botës në vitin 1995, për shkak të një incidenti, Federata Kroate e Karatesë e pezulloi për dy vjet. Pas përfundimit të karrierës vepruese, vazhdon të merret me afarizëm. (Edmond Thaçi)

IDHUJT PARAHISTORIKË. Figurina neolitike dhe eneolitike prej argjile të pjekur. Fillimisht paraqitnin figura të femrave, të lidhura me kultin e Nënës së Madhe dhe të plleshmërisë. Në fazat e hershme kishin trajta cilindrike, sy dhe flokë të incezuar dhe hundë e gjinj të modeluar. Në fazën vijuese fituan trajta konike/bikonike, me paraqitjen e qafës dhe modelimit të zbatuar edhe në flokë dhe sy, në vend të incezumit të mëhershëm. Në fazat vazhduese paraqiten edhe duart e liruara nga trupi dhe elemente të tjera. Figurinat janë paraqitur të ulura ose duke qëndruar në këmbë. Gjetjet e para në Kosovë i takojnë epokës së neolitit të hershëm dhe janë pjesë e kulturës së Starçevës. Figurina e parë u zbulua në Glladnicë (Graçanicë), e punuar mjaft vrazhdë, me trajtë shtyllë, me vija të gërricura të syve

dhe gjinj të theksuar. Figurinat e tjera kanë trajta më të përparura dhe në të shquhen edhe flokët e gjatë të trajtuar me teknikë gërricjeje (Vlashnjë), apo me duar që veçohen nga trupi (Varosh). Figurinat e neolitit të vonë dhe të eneolitit të hershëm i takojnë kulturës së Vinçës dhe këto, përmes nënfazave Vinça-Tordosh dhe Vinça-Ploçnik, sjellin një zhvillim të dukshëm në paraqitjen e hyjve. Elementet e botës shpirtërore dhe të nivelit artistik shprehen më së shumti te figurina e njohur si “Hyjnesha në fron” apo “Hyjnesha e Prishtinës” (Tjerrtorja në Prishtinë), e cila i takon variantit Kosovë-Moravë Jugore të kulturës së vonë të Vinçës. Kjo nuk ka gjinj, si shprehje e nivelit më të lartë të besimit të dualizmit gjinor. Figurina të kohës, deri më sot asnjëra e ngjashme me tjetrën, janë gjetur dhe në Runik, Bardhosh, Fafos të Mitrovicës etj. Në kuadër të idhujve paraqiten edhe në trajtë zoo-antropomorfe apo vetëm zoomorfe dhe altarë të pikturuar. Valët e dyndjeve indoeuropiane eneolitike sollën në Kosovën parahistorike frymë tjetër të idhujve, fillimisht në trajtë pete të lakuar dhe vetëm me gjinj të theksuar. (Edi Shukriu)

IKONAT (shek. IV-XVIII). Piktura me motive fetare të krishtera, të realizuara në dru e pëllhurë. Në ikona paraqitet portreti i Jezu Krishtit, i Zonjës së Bekuar, i apostujve apo të ndonjë shenjtori biblik. Kjo lloj pikturë së pari u paraqit në vendbanimin e Fajumit në Egjipt. Ikonat klasike si bazament për pikturë e kishin drurin. Po ashtu ikonat u pikturuan edhe në pëllhurë në shek. XVIII. Mund të gjenden edhe ikona të shkruara në bronz apo të realizuara në xham e gur. Ikonat në gur u realizuan në teknikën e barelievit. Madhësia e ikonave mund të jetë miniaturale, por ka edhe të formatit të madh. Ikonat janë karakteristikë e kulturës bizantine. Në Kosovës ikonat më me vlerë gjenden në fondin e Manastirit të Deçanit dhe të Patrikanës së Pejës. Ikonat kryesisht janë të shek. XIV, por edhe të kohës më të vonë. Longini ishte njëri ndër meshtarë-piktore, i cili realizoi ikona në Manastirin e Deçanit në shek. XIV. Ikonat mund të jenë njëshe, diptike dhe triptike. Ikonat kryesisht vendosen në ikonostas, por edhe në vende të caktuara të objektit fetar. Këto piktura mesjetare të stilit bizantin e postbizantin zënë vend të rëndësishëm në thesarin e manastireve ortodokse në Kosovë. (Fejaz Drançolli)

IKONOSTASET (shek. V-XIV). Janë pjesë përbërëse të enterierit të kishave të krishtera, të stilit bizantin në veçanti. Kanë formë të parmakëve dhe janë realizime nga druri, metali dhe guri, por edhe nga mermeri në raste të veçanta. Ikonostasi bën ndarjen e altarit nga anijata kryesore e kishës, në rastet kur kisha është e tipit bazilikë e stilit bizantin. Fillet e para të ikonostasis gjenden në artin e vjetër të krishterë nga shek. V-VIII. Në ikonostas vendosen ikonat e shenjtoreve nga Dhiata e Re. Ikonostasi në fillim kishte lartësi të vogël, deri 1-1.5 m, por me kohë u rrit vazhdimisht dhe, bashkë me këtë, u pasurua me dekorime plastike me vlerë artistike. Në artin bizantin ikonostasi fitoi rol të veçantë, duke zënë vend të rëndësishëm edhe në kuadër të mobilierisë kishtarë. Në pjesën qendrore a ballore të ikonostasis qëndrojnë “dyert e mëdha”, që janë mjaft dekorative. Ikonostaset kanë dekorime plastike, që shpesh kanë karakter simbolik. Në disa kisha të Kosovës gjenden ikonostase të realizuar në mermer, si në Kishën e Manastirit të Deçanit dhe në Kishën e Shën Dhimitrit në Patrikanën e Pejës (shek. XIV). Ikonostaset kosovare të rritit ortodoks veçohen me profilizime dhe dekorime të pasura plastike, janë në harmoni me mjedisin ku janë vendosur dhe ende funksionojnë si pjesë përbërëse e altarit të kishave monumentale. (Fejz Drançolli)

ILAZI Adem (Reçaku) (1884-1933). Adem Ilazi është i biri i Ilaz Reçakut, i njohur si luftëtar kundër sundimit osman. Në popull njihet më tepër me nofkën Qorr Ilazi, ngase që nga fëmijëria e kishte të dëmtuar njërin sy. Në periudhën 1912-1916 luftoi në territorin e Podrimës dhe të Ferizajt, bashkë me grupin e Budakovës, të prirë nga Jetish Behluli dhe Rexhë Bardhi. Bënte pjesë në çetën e të atit, e cila përbëhej prej 30-40 luftëtarëve nga Rrafshi i Kosovës, Drenica dhe Podrimja. Ishte pjesëmarrës i Kuvendit të Murgullës, prandaj nga fundi i qershorit 1920 për të përhapur vendimet e këtij Kuvendi mbajti një tubim në Bincë të Drenicës, ku morën pjesë çetat e Rrafshit të Kosovës, Podrimës dhe Prizrenit. Dimrin e vitit 1920/21 e kaloi në Shkodër. Kthehet nga Shkodra dhe bashkë me shokë, me luftë e lirojnë të atin e tij nga burgu i Prishtinës (1921). Si udhëheqës çete vepron deri në vitin 1928. Ishte edhe pjesëmarrës i kryengritjes së Fierit më 1934. Pas kësaj vritet në tradhti. (Liman Rushiti).

ILAZI Daut (1970-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ushtarak. Lindi në Bukovik të Gjilanit. Kreu shkollën e mesme në Gjilan, ndërsa Akademinë Ushtarake në Banjallukë të Bosnjës e Hercegovinës (1990). Në vitin 1997 u inkuadrua në radhët e njësiteve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mori pjesë në shumë beteja në Zonën Operative të Dukagjinit, të Pashtrikut, të Karadakut dhe të Nerodimes. Në Betejën e Jezercit më 27-29 shtator 1998, u plagos rëndë. Pas shërimit në Shqipëri, u kthye në Zonën Operative të Karadakut. Në Nënzonën Operative të Nerodimes ishte zëvendëskomandant, më pas shef i shtabit në këtë zonë dhe shef i Shtabit në Zonën Operative të Karadakut. Pas luftës shërbeu në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. (Ruzhdi Jashari)

ILAZI Hasnije (1967-). Filozofe, mësimdhënëse universitare. Lindi në Beograd, ku mbaroi edhe shkollimin fillor dhe të mesëm, ndërsa studimet i kreu në katedrën e filozofisë dhe të sociologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Magjistraturën dhe doktoratën në fushën e filozofisë i mbaroi në Universitetin e Zagrebit. Nga viti 1996 është mësimdhënëse e rregullt në departamentin e filozofisë të UP-së. Nga viti 2014 është kryetare e Shoqatës së Filozofëve të Kosovës, ndërsa më herët e ka udhëhequr edhe Institutin për Studime Sociale dhe Humanistike, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Është kryeredaktore e revistës shkencore “Njohja”. Ka publikuar një numër artikujsh nga fusha e filozofisë moderne dhe asaj sociale në revista dhe botime brenda dhe jashtë vendit. Ka qenë e pranishme edhe në fushën e publicistikës, me një sërë shkrimesh në gazetë ditore. H. Ilazi ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe vendore dhe ka udhëhequr disa projekte hulumtuese ndërkombëtare në Kosovë. (Agon Sinanaj)

ILAZI Imri (1963-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Komogllavë të Ferizajt. Pas përfundimit të Fakultetit të Kulturës Fizike në Prishtinës (1991), punoi në arsimin fillor dhe të mesëm në Lloshkobare dhe në Ferizaj. Në janar të vitit 1993 emigroi në Gjermani, ku qëndroi deri në mars të vitit 1998. U kthye në Kosovë dhe u angazhua për themelimin e njësiteve të UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes.

Në korrik të vitit 1998 u emërua komandant i Nënzonës Operative të Nerodimes për Ferizaj, shtabi i së cilës ishte në Jezerc. Në korrik të vitit 1998, pas një përlëshjeje me forcat serbe, u plagos rëndë. Udhëhoqi betejat e Jezercit (26-28 shtator 1998), ndërsa në nëntor, me formimin e Zonës Operative të Nerodimes, u emërua zëvendëskomandant i kësaj zone. Së bashku me Shukri Bujën udhëhoqën luftën në Reçak, që u zhvillua për mbrojtjen e trupave të të masakruarve nga Policia serbe (17-19 janar 1999). Udhëhoqi edhe betejën e Gremës, pastaj ndihmoi njësitet e Zonës Operative të Nerodimes në mbrojtje të fshatrave Mollopolc, Petrovë, Jezerc, Rancë, luftime që zgjatën 45 ditë (prill-maj 1999). Pas përfundimit të luftës mori detyra me përgjegjësi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Forcat e Sigurisë së Kosovës. (Ruzhdi Jashari)

ILAZI Qamil (1948-1999). Mësues, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Kaçanik i Vjetër të komunës së Kaçanikut. Mbaroi Shkollën Normale në Shkup. Punoi si mësues në fshatrat Kaçanik i Vjetër dhe Begracë. Në vitet '90 ishte pjesëmarrës në aktivitete e rezistencës popullore. Për shkak të veprimtarisë së tij, u arrestua dhe u dënua me 3 vjet burg (1995). Së bashku me Agim Bajramin e të tjerë mori pjesë në themelimin e pikave të para të zjarrit në Kovaçec, Bob, Gllloboqicë etj. Në gusht të vitit 1998 u caktua komandant i njësitit të UÇK-së për Kaçanik. Pas ristrukturimit të radhëve të UÇK-së, u emërua komandant i Brigadës 162 të Zonës Operative të Nerodimes. Nga gjykata serbe në Prishtinë u dënua në mungesë me 7 vjet burg. Mori pjesë në betejën e Jezercit, në Gajre, në Ivajë, në Kotlinë dhe në betejën te Përroi i Rakocit. U vra më 15 maj 1999, në luftë e sipër, në fshatin Nikoc. (Skënder Lutfiu)

ILIRËT. Populli e madhe e antikitetit, që banonte në perëndim të Ballkanit. Bërthama e etnosit ilir u krijua në fillimet e epokës së bronzit (2100 p.e.r.), mbi bazën e dyndjeve indoeuropiane (bartëse e varrimit me tuma me skelete protoeuropoidë stepikë) dhe, me gjasë, të trashëgimisë së përbërësit të mëhershëm pellazg. Procesi i krijimit u zhvillua gjatë epokës së bronzit dhe të hekurit, duke u krijuar tri grupe kulturore, që kishin të përbashkët mënyrën e varrimit me tuma, veshjen, armatimin, format e



LOKALITETITI ANTIK I ULPIANËS

qeramikës etj. Grupi jugor (i Devollit), që shtrihet në jug të lumit Shkumbin dhe përfshinte Epirin, Dasaretinë dhe Paioninë, karakterizohet nga qeramika e pikturuar me motive gjeometrike dhe ndikime kulturore të drejtpërdrejta nga kultura mikenase dhe helene. Grupi qendror (Mat-Glasinc), që shtrihet në veri të lumit Shkumbin, përfshinte edhe Dardaninë dhe trevën e dalmatëve dhe autariatëve në Bosnjë. Grupi verior shtrihet në veri të lumit Naronë dhe përfshinte liburnët, japodët etj. Rreth fundit të shek. VII p.e.r. helenët krijuan ngulime në bregdetin e Jonit dhe të Adriatikut, me të cilat filloi dhe historia e shkruar e ilirëve. Autorët antikë i konsideronin ilirët si grup popullsisht që kishin kufi verior Alpet sllovene dhe luginën e lumit Sava (japodët, breukët, autariatët); në lindje Danubin dhe malet Ballkan deri në luginën e Vardarit, me dardanët, lynkestët e paionët, ndërsa në jug një linjë që kalonte nga gadishulli i Akrokerauneve (Karaburuni), përtej luginës së Aosit (Vjosës), rrëzë maleve të Pindit me amantët, atintanët e parauejt. Epiri, që shtrihet përtej Akrokerauneve, konsiderohej si njësi më vete, por nga pikëpamja kulturore dhe gjuhësore përbënte një vazhdim të trungut ilir. Ilirët përmenden me emër të përbashkët në mesin e shek. V p.e.r. nga Herodoti (IV 48) si banorë të luginës së lumit Angros (Morava Jugore), por edhe si forcë politike që i kishte dhënë strehim mbretit maqedonas Perdika apo familjarëve të dinastisë Kadmeje, të dëbuar nga

Teba. Më 436 p.e.r. përmenden nga Tukididi (I 24 5), si forcë ushtarake, që mbështeti aristokratët, aleatë të Korkyrës, kundër demokratëve, aleatë të Korintit në luftën civile në Dyrrah. Mbret ilir i kohës përmendet Syrras, që bëri aleat mbretin Perdika të Maqedonisë, duke e martuar me të bijën, Kynën, nënë e Filipit II dhe gjyshe e Aleksandrit të Madh. Në fillim të shek. IV p.e.r. mbreti Bardhyl vuri në vasalitet Maqedoninë, ndërsa më 385 p.e.r. sulmoi Mbretërinë Molose në aleancë me Dionisin e Madh të Sirakuzës, duke rivendos në fron mbretin Alketas, nga dinastia Eakide. Pas dy fitoreve mbi maqedonasit (369 p.e.r., 359 p.e.r.) ky pësoi disfatë kundër Filipit II të Maqedonisë (356 p.e.r.). Po atë vit, me ndihjen e Athinës, mbreti Grabos, pasardhës i Bardhytit, lidhi aleancë antimaqedonase me mbretin Ketripor të Trakisë, por u sulmua befasisht nga Filipi dhe humbi fronin. Në betejën e vitit 344 p.e.r. Filipi zotëroi Dasaretinë dhe pastaj në skenën politike ilire doli mbreti Pleurias, krijues i dinastisë së re, me qendër në Ilirinë bregdetare, në kështjellën e Gurëzezës (Cakran). Më 335 p.e.r. mbreti Kliti, pasardhës i Bardhytit, drejtoi kryengritjen antimaqedone me mbretin taulant Glaukias, e cila u shtyp nga Aleksandri i Madh. Më 317 p.e.r. Glaukia strehoi Pirron dyvjeçar, të përzënë nga Epiri nga partia promaqedonase. Si reagim, gjenerali maqedonas Kasandri pushtoi tokat e Mbretërisë Ilire dhe kolonitë helene: Apolloninë dhe Dyrrahun më 314 p.e.r., por pas dy vjetësh këto qytete u çliruan me ndihmën e mbretit ilir Glaukia, që mbajti Dyrrahun. Pasardhësi i tij Monuni ishte i pari që preu monedha argjendi me titullin “mbret” (basileos), mbajti kontrollin mbi Dyrrahun dhe sulmoi Maqedoninë më 282 p.e.r. Bashkëkohës i tij në trevën e enkelejve ishte Bardhyli i Ri, vjehërr i Pirros. Mytili, pasardhësi i Monunit, luftoi rreth vitit 270 p.e.r. kundër mbretit Aleksandër II të Epirit, djalit të Pirros, në aleancë me Apolloninë dhe Lidhjen Etole. Mbreti Pleuria II (Pleurat) rivendosi zotërimin e Mbretërisë Ilire në prapatokën e Dyrrahut dhe të Apollonisë deri në trevën e ardiejve, në veri të Rizonit. Biri i tij Agroni nisi politikë aleance me Maqedoninë dhe më 231 p.e.r. shpëtoi nga rrethimi epirot dhe etol, Medionin kryeqytetin e Akarnanisë. Teuta, trashëgimtarja e tij, nisi më 230 p.e.r. flotën ilire kundër aleatëve të Epirit, Lidhjes Ahease dhe pushtoi Foinikën, kryeqytetin e Koinonit

Epirot. Më pas bëri paqe me epirotët, duke e liruar Foinikën dhe duke nënshkruar aleancë me ta dhe akarnanët kundër Lidhjes Etole dhe asaj Ahease. Po atë vit Teuta u ndesh edhe me Mbretërinë Dardane, që kishte shkëputur disa krahina kufitare të Mbretërisë Ilire. Më 229 p.e.r. flota e Teutës rrethoi kolonitë helene të Isës, Dyrrahut dhe Apollonisë, pushtoi Korkyrën dhe shpartalloi flotën akease. Për këtë romakët nisën Luftën I Iliro-Romake (229-228 p.e.r.), me flotë prej 200 anijesh. Ushtria zbarkoi në Korkyrë, që u dorëzua me tradhti nga komandanti i garnizonit ilir, Demetër Fari. Pastaj pushtoi Apolloninë dhe Dyrrahun, e çliroi nga rrethimi ilir ishullin Isa. Sipas traktatit të nënshkruar midis Teutës dhe Senatit Romak (228 p.e.r.), mbretëresha detyrohej t'i paguante Romës tribut vjetor, ndërsa kufijtë e Mbretërisë Ilire u shtynë në veri të lumit Ardaksan (Gjadër). Tokat në jug të kufirit shkëputeshin nga Mbretëria Ilire dhe formonin një protektorat romak. Pas vdekjes së Teutës, Demetër Fari u bë tutor i djalit të vogël të Agronit, Pinesit, të pranuar si mbret i ilirëve nga Roma. Ndërkohë Demetër Fari pushtoi tokat e Koinonit të Atintanisë dhe qytetin Dimal dhe bëri aleancë me mbretin Filip V të Maqedonisë, andaj më 219 p.e.r. Senati Romak e nisi Luftën II Iliro-Romake. Konsulli L. Emili pushtoi Dimalin dhe qytetet e Atintanisë, theu Demetër Farin në ishullin Far dhe nënshkroi traktat të ri me Mbretërinë Ilire, që përfaqësohej nga mbreti Pines. Gjatë Luftës II Punike (218-201 p.e.r.) u zhvilluan ndeshje luftarake në territorin ilir midis romakëve dhe Filipit V të Maqedonisë, aleat i Hanibalit dhe mbreti i Ilirisë Skerdilaidi mbajti anën e Romës. Fitorja e konsullit T. K. Flamini kundër Filipit V në ngushticat e Aosit (Dragot i Tepelenës, 197 p.e.r.) i siguroi Mbretërisë Ilire të Pleuratit kontrollin mbi koinonet e Parthinëve dhe Dasaretëve me kryeqendrat Partha (Berati) dhe Lyhnida (Ohri). Pleuratin e trashëgoi i biri Genti (181 p.e.r.), që nisi përgatitjen për luftë kundër Romës, duke krijuar flotë prej 270 anijesh, ushtri me 15,000 luftëtarë dhe aleancë me Perseun, mbretin e Maqedonisë. Lufta III Iliro-Romake filloi më 168 p.e.r. me sulm të 80 anijeve të Gentit kundër Dyrrahut dhe Apollonisë. Pretori L. Anic Gali, komandant i trupave romake për Ilirinë, e detyroi tërheqjen e flotës së Gentit

dhe i mundi ilirët para mureve të Skodrës, kryeqytetit ilir. Mbreti Gent u dorëzua bashkë me familjen dhe pasurinë dhe u dërgua në Romë dhe pastaj në Gubio, ku vdiq si mbret i fundit i shtetit ilir. Romakët vazhduan edhe përreth njëqind vjet pushtimin e tokave veriore dhe lindore ilire. Më 178 p.e.r. pushtuan Istrian, më 155 p.e.r. Koinonin e Dalmatëve, ndërsa më 135 p.e.r. territoret e ardiejve dhe të plerejve. Në vitin 84 p.e.r. zbarkoi në Dyrrah ushtria e konsullit G. Skriboni, i cili sulmoi Dardaninë dhe doli për herë të parë në Danub. Romakët ruajtën edhe në veri organizimin tradicional të krahinave mbi bazën e koinoneve/civitas. Në vitin 59 Senati Romak bëri organizimin e territoreve të pushtuara ilire në veri të lumit Drin deri tek Istria dhe formoi provincën e Ilirikut, me kryeqytet Naronën. Iliria u bë vendi ku u vendos fati i Republikës Romake, nga ndeshja midis forcave ushtarake të Cezarit dhe Pompeut në Petra të Dyrrahut (Shkëmbi i Kavajës. 48 p.e.r.) dhe nga kryengritja e madhe ilire e viteve 6-9. Pas shtypjes së kryengritjes ilire, u krijuan dy provinca të qeverisura nga perandori: Iliriku i Sipërm (Dalmatia), dhe Iliriku i Poshtëm (Panonia). Gjatë sundimit të Perandorisë Romake ilirët u dalluan kryesisht në fushën ushtarake dhe gjatë shek. III-IV dhanë një radhë perandorësh: Traian Deci (249-251), Aurel Klaudi (268-270), Aureliani (270-275), Probi (276- 282), Diokleciani (284-305), Konstantini (313-337), që u dalluan si reformatorë të shtetit dhe religjionit romak si dhe, më pas, të Perandorisë Bizantine, si Justini dhe Justiniani. (Neritan Ceka).

ILIRIKU I SHENJTË (ILLYRICUM SACRUM). Vepër enciklopedike, dokumentare, e mbështetur në burime arkivore, që i kushtohet historisë kishtarë të Ilirisë, e botuar në IX vëllime gjatë viteve 1751-1819, me rreth 55,000 faqe. Tetë vëllimet e para përmbajnë material dokumentar, ndërkaq vëllimi IX titullohet “Shtesa dhe korrigjime” (“Accessiones et Correctiones”). Vepra u hartua nga tre jezuitë: Filip Riçeputi (1667-1742), Daniel Farlati (1690-1773) dhe Jakopo Koleti (1734-1827).

F. Riçeputi kishte shërbyer disa vjet si klerik ushtarak në Ballkan në shërbim të Republikës së Venedikut. Pas kthimit në Romë vendosi t’i përkushtohet shkrimit të historisë kishtarë të Ilirikut. Projektin e tij për këtë vepër me titull “*Prospectus Illyrici Sacri cuius historiam*

describendam typisque mandandum suscipit, 1720” ia kishte propozuar papa Klementit XI Albani, i cili e kishte përkrahur atë. Në punën e tij, Riçeputin e ndihmoi jezuiti Farlati. Këta të dy rreth 20 vjet hulumtuan lëndë arkivore për të grumbulluar rreth 300 vëllime material në dorëshkrime. Pas vdekjes së Riçeputit (1742) punën do ta vazhdojë Farlati. Nën përkujdesen e tij u botuan pesë vëllimet e para, por edhe ky nuk arriti ta përfundonte punën e nisur, kështu që projektin e vazhdoi Jakopo Koleti. Vëllimi i parë (1751) dhe i dytë (1753) i “*Illyricum Sacrum*” përmban historinë e Ipeshkvisë së Salonës deri në shkatërrimin e saj. Vëllimi i tretë (1765) përfshin Ipeshkvinë e Splitit në Dalmaci; vëllimi i katërt (1769) ipeshkvitë sufragane të Splitit; vëllimi pestë (1775) Ipeshkvinë e Zarës me sufraganet e saj. Vëllimi gjashtë (1800) përshkruan Ipeshkvinë e Dubrovnikut dhe sufraganet e saj. I shtati (1817) përfshin ipeshkvitë e Dioklesë, Tivarit, Durrësit si dhe ipeshkvi të tjera shqiptare. Vëllimi tetë (1819) përfshin ipeshkvitë në Shkup, Pejë, Sofje, Ohër dhe Tërnovë. Vëllimi nëntë përmban shtesa dhe korrigjime. Katër vëllimet e para i kishte publikuar Farlati, i pesti u botua pas vdekjes se tij, ndërsa tri të fundit i publikoi Koleti. Edhe vëllimin e nëntë e kishte përgatitur Koleti, por u publikua pas vdekjes se tij (1901-1909), nën përkujdesjen e historianit kroat, Frane Buliç. (Muhamet Mala)

ILIRISHTJA. Gjuhë e ilirëve. Ilirët shtriheshin në tërë Ballkanin Perëndimor, nga Morava e Vardari në Lindje, te Sava në Veri e deri në Adriatik e në detin Jon. Nuk ka mbishkrime ilire. Studiuesit mbështeten kryesisht në fjalë të rralla ilire të përmendura në burimet klasike, si dhe në glosa, emra vendesh, njerëzish, lumenjsh dhe popujsh. Në bazë të analizës së glosave të pakta dhe emrave të njerëzve e vendeve mendohet se mund të ketë pasur disa varietete ilire. Pjesa më e madhe e studiuesve mendojnë se ilirishtja e jugut, ajo e *Illyrie proprie dicti*, do të ketë qenë paraardhësja e shqipes. Nga shek. XVIII e tëhu shumë studiues e kanë pohuar si pararendëse të shqipes. Po ashtu, pjesa më e madhe e studiuesve e konsideron si gjuhë indoeuropiane, madje si degë të veçantë të gjuhëve indoeuropiane. Shumë studiues mendojnë se mesapët në Italinë e Jugut ishin me prejardhje ose të afërt me ilirët. Fragmente nga mbishkrimet mesape shpesh janë interpretuar

si gjuhësisht të afërta me ilirishten dhe madje edhe me shqipen. Këto mbishkrime mesape nuk janë krejtësisht të mjaftueshme për të përcaktuar as nëse mesapët kanë qenë ilirë, as nëse gjuha e tyre është pararendësja e shqipes, ndonëse disa fragmente si menzana (mëz), ose bhilia (bijë) mund të tregojnë njëfarë afrie me shqipen. Iliria ka qenë në luftë të vazhdueshme me Romën qysh nga shek. III p.e.s dhe është pushtuar përfundimisht në vitin 42 p.e.s, kur u themelua Provinca Illyricum. Një analizë të thelluar të glosave ilire e ka bërë Hans Krahe në pjesën e parë të shek. XX. Radoslav Katiçiq, mbështetur në emrat e njerëzve që paraqiten në Ilirikum, ka bërë një ndarje të tri zonave dialektore: Ilirët e Jugut në territorin në jug të Malit të Zi, përfshirë pjesën më të madhe të territorit të sotëm të Shqipërisë; Ilirishten qendrore që përfshin pjesën në veri të Malit të Zi dhe liburnishten. Katiçiqi mendon se shqiptarët ndërlidhen me ilirët e jugut. (Bardh Rugova)

ILJAZI Ali (1949-). Mjek, internist, pulmolog, primarius. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë (1973). Kreu specializimin për mjekësi interne gjithashtu në Sarajevë dhe në vitin 1988 mori titullin primarius. Mbrojtiti tezën e doktoratës në Novi-Sad dhe mori titullin doktor i shkencave të mjekësisë. Në vitin 1994 botoi monografinë “Testet bronkoprovokuese në diagnostikën e hiperreaktivitetit bronkial”. Për punën shumëvjeçare mori shumë dekorata dhe mirënjohje. Ishte shef i shërbimit pulmologjik në Institutit Kombëtar të Mjekësisë së Punës në Gjakovë dhe dekan i Fakultetit të Infermierisë në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë. Ka marrë pjesë në shumë kongrese e simpoziume ndërkombëtare dhe ka publikuar një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Isme Humolli)

ILJAZI Fahri (1903-1985). Klerik dhe mësimdhënës. Lindi në Gjakovë, ku mori edhe arsimin fillor, më pastaj vazhdoi në Medresenë e Madhe të Gjakovës dhe në Medresenë e Madhe “Mehmet Pasha” në Prizren. Ndërkohë i dha edhe provimet për hafiz, përkatësish myderriz. Në vitet 1930-1948 ishte mësimdhënës, përkatësisht drejtor i Medresesë së Madhe në Gjakovë. Krahas shërbesave fetare bëri tran-

skriptimin e vepës “Vehbije” të Tahir efendi Gjakovës (1950), përsosi “Mevludin” e Tahir efendi Popovës, mori pjesë në hartimin e doracakut “Ilmihali i vogël” (1957). Në dorëshkrim la veprën “Jasin” të përkthyer nga gjuha arabe. Hafiz F. Iljazi ka qenë udhëheqës i Bashkësisë Islame të Gjakovës dhe personalitet i respektuar i këtij qyteti. (Izet Musaj)

ILMIHALI. Doracak themelor për njohuritë fetare islame. Ka kuptimin “gjendje e diturisë” apo “nivel i diturisë”. Ky libërth nisi të përdoret në Kosovë nga viti 1956, ndërsa në Shqipëri u përdor që nga viti 1923. Meqenëse iu dedikohet të rinjve, iu dha atributi “Ilmihal i vogël”. Botimi i parë i tij u lejua nga Bashkësia e Fesë Islame në Sarajevë (1957) për gjithë ish-Jugosllavinë, ndërsa botimi në gjuhën shqipe u lejua nga kryesia e Bashkësisë së Fesë Islame të Serbisë, me seli në Prishtinë. Botimi i parë u shtyp në 25,000 kopje, ndërsa një vit më vonë botimi i dytë u shtyp në 15,000 ekzemplarë. Përkthimin e Ilmihalit në gjuhën shqipe e kishte bërë Hafiz Bajram Agani, në bashkëpunim me Mehmet Gjevorin. “Ilmihali i vogël” ishte i hartuar në formë pyetjesh e përgjigjesh dhe ndahej në tri pjesë: në pjesën e parë flitej për besimin islam, në të dytën për obligimet fetare dhe në të tretën për mirësjelljen fetare. Ndërkohë janë hartuar dhe botuar lloje të ndryshme ilmihalash në gjuhën shqipe. (Qemajl Morina)

IMAMI Ferid (1892-1937). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë ku kreu shkollën fillore dhe atë plotore. Në vitet 1908-1911 kreu normalen turke në Shkup dhe kthehet në Gjakovë, ku emërohet kryemësues në shkollën plotore të qytetit. Rinisë gjakovare fshehurazi ua mësonte shkrimin dhe leximin shqip. Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë vijoi një kurs 6-mujor në Normalen e Beratit, pas të cilit caktohet mësues në Tiranë. Në vitin 1915 kthehet në Gjakovë, ku punoi si mësues në shkollën shqipe deri në vitin 1918. Në vitin 1921 ishte mësues në rrethin dhe qytetin e Kukësit, në Golaj dhe në Bicaj të Lumës, deri në fund të vitit 1924. Ishte simpatizant i Revolucionit të Qershorit (1924) dhe mbrojtës i idealeve të tij. Autoritetet qeveritare të A. Zogut e arrestuan, e dënuan me vdekje, por më pas e liruan. Gjatë viteve 1928-1931 punoi si llogaritar në Bashkinë e Gjakovës. Më pas punoi si mësues në Tiranë, në Kukës dhe në Dibër. (Jusuf Meqa)

IMAMI Nesrina (1958-). Mjeke, mikrobiologe, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1981). Mbaroi studimet pasuniversitar në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Kreu specializimin për mikrobiologji në Prishtinë. Fillimisht punoi në Entin Krahinor për Mbrojtjen



NESSRINA IMAMI

Shëndetësore në Prishtinë, ndërsa studime pasuniversitare në lëmin e imunologjisë i vazhdoi në Londër, në Shkollën Mjekësore Mbretërore të Universitetit të Londrës. Kishte interesim të veçantë në lëmin e imunitetit qelizor, limfociteve dhe përsosjen e vaksinave dhe të imunoterapisë kundër sëmundjeve infektive. Më 1992 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Universitetin e Londrës dhe vazhdoi hulumtimet në “Hammersmith Hospital” në “Royal Postgraduate Medical School”. Nga viti 1997 punon dhe vepron në “Chelsea & Westminster Hospital”, është profesore e lëndës së imunologjisë për studime të rregullta dhe pasuniversitare. Është autore e shumë publikimeve shkencore, e disa kapitujve të teksteve universitare dhe ka bërë mbi 100 prezantime në konferenca dhe kongrese shkencore ndërkombëtare. (Isuf Dedushaj)

IMAMI Osman (1936-1996). Mjek, infektolog, mikrobiolog, profesor universiteti, akademik. Lindi në Hasanbeg të Shkupit. Aty e mbaroi shkollën fillore, gjimnazin e kreu në Pejë, ndër-



OSMAN IMAMI

sa studimet i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1961). Pas diplomimit punoi si mjek në Pejë. Specializimin nga mikrobiologjia humane e kreu në Beograd dhe më pas u bë drejtor i Entit Higjienik të Pejës dhe drejtor i përgjithshëm i Qendrës Mjekësore të Pejës (1965-1966). Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Zagrebit në vitin 1968 dhe po në Zagreb specializoi për infektologji (1969). Në vitin 1969 u emërua drejtor i repartit për së-

mundje infektive të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë u emërua dekani i parë i këtij fakulteti (1969-1973). Tezën e doktoratës e mbrojti në Zagreb në vitin 1971, duke u bërë doktori i parë i shkencave mjekësore në Kosovë. Gjatë viteve 1971-1973 ishte në specializim në Hjuston të SHBA-së, ndërsa më vonë (1974-1975) qëndroi në Institutin Nacional të Suedisë në Stokholm. Pas kthimit nga Suedia u emërua drejtor i Entit për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës. Me emrin e tij lidhet ngushtë edhe Instituti i Mikrobiologjisë, të cilin e udhëhoqi për shumë vjet. Në vitin 1979 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale, të publikuara brenda dhe jashtë vendit. Është hartues i tri teksteve universitare nga lëmi i mikrobiologjisë, infektologjisë dhe imunologjisë: “Sëmundjet akute infektive” (1977), “Imunologjia” (1977) dhe “Mikrobiologjia dhe parazitologjia e medicinave” (1982), si dhe përkthyes i disa teksteve universitare nga gjuha angleze. Nga viti 1989 punoi dhe veproi në Nju-Jork. Vdiq dhe u varros në Nju-Xhersi, SHBA. (Isuf Dedushaj)

IMAMI Petrit (1945-). Dramaturg, skenarist, mësimdhënës universiteti. Lindi në Prizren. Shkollimin bazë e mori në Beograd, ku kreu dhe studimet universitare për dramaturgjii në



PETRIT IMAMI

Akademinë e Teatrit, Filmit, TV-së dhe Radios të Universitetit të Beogradit. Gjatë viteve '70 punoi si dramaturg në Radiotelevizionin e Prishtinës për disa vjet. Shkroi skenarin për filmin e metrazhit të gjatë “Era e Lisi” (1979), për të cilin fitoi çmimin “Arena e Artë” në Festivalin e Filmit në Pulë, Kroaci (1979). Nga viti 1981 është mësimdhënës për lëndën e skenarit të filmit në Fakultetin e Arteve të Dramës në Beograd. Botoi libra për teorinë e skenarit dhe shkrime të ndryshme publicistike. Në gjuhën serbe i botoi librat “Skenari i filmit në teori dhe praktikë” I,II (1978, 1983), “Serbët dhe shqiptarët gjatë shekujve” I-II (1999, 2000), “Fjalor filmik anglisht-serbisht” (2001), “Fjalor

i slengut të Beogradit” (2002, 2003, 2007) etj. Për shumë vjet ishte shef i katedrës së dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve të Dramës në Beograd. (Visar Krusha)

IMAMI Sitki (1912-1971). Shkrimtar, publicist, përkthyes, leksikograf. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor në Krumë, rrethi i Kukësit. Gjymnazin e vazhdoi në Shkodër. Punoi në administratë si nëpunës. Ishte pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare. Punoi si gazetar dhe përkthyes në Radio Jugosllavia në Beograd. Ishte njëri ndër bashkëpunëtorët e parë të revistave “Jeta e re”, “Përparimi”, “Zani i rinisë”, “Flaka e vllaznimit” etj.. Tregimin e parë e botoi në gazetën “Rilindja” në vitin 1946. Më 1953 në Prishtinë botoi përmbledhjen me tregime “Drejt ditëve të reja”. Është bashkautor i Fjalorit serbokroatisht-shqip dhe shqip-serbokroatisht (1974). Përktheu nga gjuha serbokroate disa vepra të letërsisë jugosllave, pastaj përralla të Andersenit dhe vëllezërve Grim. Në tregimet e tij trajton tema sociale, me prirje humoristike. (Isak Shema)

IMARETET. Kuzhina publike (bamirëse), ku përgatitej dhe shpërndahej ushqimi falas për skamnorët, udhëtarët e varfër, bonjakët, të sëmurët, nxënësit etj. Zakonisht në imarete jepej ushqimi i ngrohtë, një ose dy shujta në ditë. Të premtëve dhe gjatë festave jepej ushqim më i pasur. Imaretet janë ngritur në komplekset e shumë xhamive. Financoheshin nga të hyrat e vakëfeve ose nga donacionet e besimtarëve. Në Kosovë njihet imareti në Kaçanik, i ngritur në shek. XVI nga kryeministri (sadriazemit) i Perandorisë Osmane, Koxha Sinan pasha. Në fund të shek. XVI, Mustafa Pasha, pranë xhamisë së vet në Prizren, ndërtoi dhe një imaret. Nga mesi i shek. XIX objekti u rrënua dhe u ngrit një imaret i ri, që ka shërbyer si i tillë deri në fund të shek. XIX. I njohur ishte edhe imareti i ndërtuar nga Jemishqi Hasan Pasha në Rogovë të Hasit (shek. XVI). Dervish Beu në Prizren kishte ndërtuar një bujtinë, në të cilën udhëtarët e kishin falas ushqimin dhe fjetjen deri në tri ditë. Edhe ky imaret funksionoi deri nga mesi i shek. XIX. Po ashtu, në fund të shek. XVIII në Prizren, në qytetin e lindjes së tij, mytesarifi i Prizrenit Tahir Pashë Rrotulla kishte ndërtuar disa imarete. (Parim Kosova)

IMERI Banush (1942-). Veprimtar i arsimit, pedagog. Lindi në Shtime, ku kreu edhe shkollën fillore, ndërsa shkollën normale e kreu në Ferizaj. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Prej vitet 1967-1975 ka qenë mësimsdhënës i lëndëve pedagogjike në shkollën normale në Ferizaj. Në vijim ka qenë drejtor i Qendrës së Arsimit të Mesëm të Orientuar, pastaj i entit special në Ferizaj, si dhe inspektor komunal i arsimit. Ndërkohë, është marrë edhe me aktivitete të tjera shoqërore, arsimore, sociale, sportive dhe kulturore. Është autor i disa veprave: “Shtimja me rrethinë” (2003), “Arsimi dhe shkollat në komunën e Shtimes 1912-2012” (2012) etj. (Hajrullah Koliqi)

IMERI Gani (1967-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Dumnicë e Epërme, komuna e Vushtrrisë. Në vitin 1989 emigroi në Kroaci, në Slloveni dhe Austri. Gjatë vitit 1997 ishte në grupin e bashkatdhetarëve që siguronte armatim për luftën në Kosovë. Me fillimin e luftës u kthye në Kosovë dhe vazhdoi kontributin e tij në radhët e UÇK-së. Më 18 prill 1998 bënte pjesë në njësitin e parë të UÇK-së, që doli publikisht në Zonën Operative të Shalës. Fillimisht ishte komandant i batalionit III të Brigadës 141 “Mehë Uka”, ndërsa më vonë, me formimin e batalionit IV “Rexhep Musa”, u emërua komandant i tij. Mori pjesë në shumë aksione ushtarake kundër forcave serbe në Kosovë dhe kontribuoi në luftën çlirimtare edhe në Zonën Operative të Llapit, pastaj në ofensivën e Rahovecit etj. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (1999-2003) dhe më pas ushtroi funksione në komunën e Vushtrrisë. (Sabit Sylja)

IMPORTI. Sasia apo vlera e të gjitha produkteve dhe shërbimeve të blera nga vendet e tjera. Edhe pse shpërpjestimi në tregtinë e jashtme mund të prodhojë probleme të mëdha makroekonomike, importet janë të rëndësishme për ekonominë në zhvillim, siç është Kosova, pasi paraqesin një nga mënyrat për t’iu qasur teknologjive të reja dhe të avancuara. Gjithashtu, për këto vende importi është burim i dijes. Për më tepër, me integrimin ekonomik që e shohim dekadave të fundit, importet janë shumë të rëndësishme në kontekst të përfshirjes së kompanive të vendeve

në zhvillim në rrjetet globale të prodhimit. Në rastin e Kosovës, niveli i importeve, veçanërisht ai i produkteve, është tepër i lartë dhe arrin vlerën prej 2,5 miliardë eurosh, apo mbi 50 për qind të brutoprodhimit vendor. Në strukturën e importeve kosovare një pjesëmarrje të madhe kanë edhe sektorët dhe produktet apo shërbimet, të cilat mund të prodhohen edhe në Kosovë, veçanërisht produktet e konsumit të gjerë. Reduktimi i nivelit të importit të produkteve, që gjeneron bilanc të lartë negativ, së bashku me reduktimin e papunësinë, është një nga sfidat kryesore të politikave ekonomike në Kosovë. (Petrit Gashi)

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT. Një tregues që mat mesataren e peshuar të çmimeve të një shporte normale të konsumatorit final. Në shportën e konsumatorit përfshihet një numër i konsiderueshëm i produkteve dhe i shërbimeve që konsumohen nga konsumatori mesatar i një vendi të caktuar. Indeksi i çmimeve të konsumit kalkulohet duke marrë parasysh ndryshimet në çmimin e secilit produkt apo shërbim të përfshirë në shportën e konsumatorit. Produktet dhe shërbimet në shportën e konsumatorit janë të peshuara varësisht nga rëndësia e tyre. Ndryshimet në indeksin e çmimeve të konsumit shfrytëzohen për të vlerësuar ndryshimet në çmimet e përgjithshme në ekonomi, por edhe të ndryshimeve në koston e jetesës. Indeksi i çmimeve të konsumit është njëri nga treguesit më të përdorur, për të shprehur lartësinë e inflacionit në ekonomi. Në Kosovë ky indeks botohet rregullisht nga Enti i Statistikave të Kosovës. Kosova ka përjetuar trend të ulët të rritjes së çmimeve në vitet 2013 e 2014. Çmimet e konsumit pritet të mbesin të ulëta edhe në periudhën afatmesme: 0.2% në 2015 dhe mesatarisht 0.5% në periudhën 2016-2017. Normat e ulëta të inflacionit parashikohen si rezultat i stabilizimit të çmimeve të dy komponentëve me peshë më të madhe në indeksin e çmimeve të konsumit, të ushqimit dhe të transportit, si rezultat i trendit të uljes së mëtejme të çmimeve të produkteve ushqimore dhe të naftës në tregjet botërore (Alban Zogaj).

INDUSTRIA E GOMËS DHE KIMIKE “BALLKAN”, SUHAREKË. U themelua në vitin 1961. Në vitin 1964 në fabrikë filloi prodhimi i shiritave transportues, me kapacitet 500

tonë në vit, duke e zgjeruar prodhimtarinë në vitin 1966 me prodhimin e rripave trapezë me kapacitet prej 1,000,000 m². Më pas (1978) filloi prodhimi i pëlhurave teknike me kapacitet prej 4,000, 000 m². Fabrika kishte këto kapacitete: shirita transportues të gjerësive 200-3,200 mm, të të gjitha forcave këputëse të pëlhurave 1,000-7,000 N, si dhe shirita me kord çeliku me kapacitet prej 20,000 tonë në vit, rripa trapezë të të gjitha profileve dhe dimensioneve me kapacitet prej 1,400 tonë në vit, gomë të imët teknike me kapacitet prej 250 tonësh në vit. Kishte në pronësi objekte me sipërfaqe prej 466,000 m² dhe oborr 107,400 m². Në vitet ‘90 fabrika kishte mbi 1,800 punëtorë, kurse në vitet 1999 deri 2005 rreth 700 punëtorë. Në vitin 2005 fabrika u privatizua nga kompania Newko Ballkan LLC. (Musli Bajraktari)

INDUSTRIA E SINTERMAGNEZITIT, STREZOC DHE GOLESH. Hulumtimet e para në vendburimet e magneziteve në Kosovë kanë filluar në vitin 1920. Xehërorët e nxjerrë janë trajtuar me procesin e separimit dhe pastaj i janë nënshtruar procesit të pjekjes në furrat e thjeshta ose rrotulluese. Më vonë, mbështetur në magnezitet e Strezocit, janë prodhuar sintermagneziti, magneziti kaustik dhe magneziti pluhur (1974). Me këto prodhime nga minierat e Kosovës janë plotësuar nevojat e ish-Jugosllavisë, ndërsa një pjesë është eksportuar. Për shkak të zvogëlimit të rendimentit të xehërorëve, në vitin 1987 u bë riorientimi i nxjerrjes së xehërorëve nëpërmjet galerive. Në këtë mënyrë u mundësua shtimi i prodhimit në sasi prej 120,000 tonësh me rendiment prej 35%. Deri në vitin 1990 magneziti i pasuruar shërbente si lëndë e parë për prodhimin e sintermagnezitet në Strezoc, në sasi 510,000 tonë në vit. Në minierën e Goleshit dhe të Strezocit ishin të punësuar rreth 1,300 punëtorë. Në programin e zhvillimit të mëtejshëm ishte planifikuar edhe ndërtimi i pajisjeve për shkrirjen e magnezitit. Prodhimtaria në impiantin e Strezocit ndërpritet me futjen e masave të dhunshme në vitin 1990. Pas vitit 1999 miniera e Strezocit u privatizua, por prodhimtaria nuk rifilloi asnjëherë. Xehet e papërpunuara u shitën për ndërtim të rrugëve. Në minierën e Goleshit po ashtu është ndërprerë prodhimi me futjen e masave të dhunshme nga Serbia. Pas vitit 1999, vendburimi i Goleshit me

të gjitha pajisjet është përmbytur nga uji. Miniera është privatizuar, por për shkak të moskryerjes së obligimeve, prodhimi është ndërprerë me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Rekomandohet studimi dhe analiza e gjendjes ekzistuese për marrjen e vendimit për rifillim të prodhimit. Rezerva të konsiderueshme të magneziteve janë verifikuar edhe në Duboc, afër Vushtrisë, ku ende nuk ka filluar shfrytëzimi. (Shefqet Rashani)

INDUSTRIA E TEKSTILIT “KOSOVKA” (“KOSOVATEX”), PRISHTINË. Fabrika u ndërtua në vitin 1952, prodhonte fije të pambukut dhe ishte njëra nga fabrikat e tekstilit më në zë në Kosovë. Fabrika punoi me kapacitet të plotë deri në vitin 1990 dhe prodhimet e saj plasoheshin në tregun e ish-Jugosllavisë (rreth 60%) dhe në tregun e Bashkimit Europian (rreth 40%). Pas më shumë se 30 vjet të punës së suksesshme (1982), si rezultat i ndërtimit të makinave dhe pajisjeve të reja, “Kosovka” rriti numrin e punëtorëve nga 228 në 1,700, duke rritur edhe aftësinë e prodhimit në rreth 8,500 tonë tjerë në vit. Në fillim kjo fabrikë ka operuar me vetëm 20,000 boshte tjerëse, të instaluar për fije të koordinuara. Në vitin 1999 fabrika u riemërua “Kosovatex” dhe në këtë vit kishte të instaluar pajisjet me 44,000 boshte tjerëse për fije të koordinuara dhe rreth 900 turbina për tjerje, të cilat mundësonin rreth 54 thurje për të siguruar një prodhim cilësor, siç janë endjet “Keper”, “Atlas” etj. “Kosovatex” u privatizua me Spin-Off (2006) nga kompania “Ecolog International” e Tetovës. Në vitin 2010 pronari i ri bëri investime të rëndësishme, duke ndërtuar dhe kompletuar një vijë teknologjike të pajisjeve për prodhimin e xhinsit. Tani “Kosovatex” nuk është fabrikë për prodhimin e tjerit, por vetëm të konfeksionit, me teknologji moderne. (Musa Rizaj).

INDUSTRIA GRAFIKE. Prodhimtaria grafike në Kosovë filloi në gjysmën e dytë të shek. XX, me botimin e gazetës “Rilindja” në Prizren (1945) dhe të librave të parë të shtypur në shtypshkronjën shtetërore. Dy vjet më vonë shtypshkronja “Rilindja” nga Prizreni kaloi në Prishtinë si NGBG “Rilindja” më 1947. Në këtë vit shtypshkronja vazhdoi punën në Prishtinë, si Shtypshkronja Krahinore e Frontit Popullor. Në vitin 1968 filloi përdorimi i teknologjisë moderne të shtypjes, e cila vazhdoi të fuqizohet



PAMJE E NJË SHTYPSHKRONJE

veçmas me futjen në përdorim të teknikës së re të radhitjes, fotoradhitjes. Shtypshkronja “Rilindja” gjatë viteve 1980-1990 ishte ndër shtypshkronjat më të mëdha në Ballkan dhe në Europën Juglindore. Në të shtypeshin libra të botuesve të njohur nga Polonia, Gjermania Lindore, Hungaria, Sllovenia etj., por edhe libra shkollorë nga “shtetet e painkuadruara”. Në këto vite shtypshkronja “Rilindja” kishte të punësuar rreth 1,600 punëtorë dhe ishte e pajisur me makineri moderne për shtyp (dy rotativa të mëdha për shtypjen e gazetave, disa makina ofset për shtypjen e librit, me libërlidhtoren e automatizuar etj.). Kosova përveç shtypshkronjës në Prishtinë, kishte shtypshkronja edhe në Prizren, Mitrovicë, Gjiilan, Gjakovë, Pejë dhe Ferizaj. Përveç shtypshkronjave publike, edhe në këtë periudhë në Kosovë kishte rreth 20 shtypshkronja private. Me futjen e masave të dhunshme në Ndërmarrjen Gazetare Botuese Grafike (NGBG) “Rilindja” në vitin 1990 fillon dëmtimi i shtypshkronjës, sa për shkak të amortizimit të makinerisë, po aq edhe për shkak të mosshfrytëzimit të kapaciteteve dhe grabitjes së makinave dhe të pajisjeve. Kjo rrethanë ndikoi që në Kosovë, veçmas në Prishtinë, të fillojë të ngrihet sektori privat i industrisë grafike. U hapën një numër shtypshkronjash private, kryesisht me makina të përdorura (ofsete dyngjyresh), të importuara nga vendet europiane. Nga këto shtypshkronja private gjatë viteve ’90 të shekullit të kaluar përftohën prodhime grafike me cilësi të kufizuar, që i dedikohen kryesisht tregut të Kosovës. Pas vitit 1999 industria grafike në Kosovë pëson një rivitalizim të shpejtë. Administratat ndërkombëtare e vendosur në Kosovë fut në përdorim produkte moderne

grafike, publikime, libra, fletëpalosje, broshura, reklama etj. dhe bashkë me to vihen në funksion edhe makineri moderne, me cilësi më të avancuar të shtypjes dhe me kapacitete më të mëdha. Aktualisht në Kosovë funksionojnë mbi 60 shtypshkronja, disa prej të cilave, si “Koha”, “Zëri” dhe “Kosova sot” kanë në përdorim makina për shtypjen e gazetave të përditshme. (Musa Rizaj).

INDUSTRIA USHQIMORE. Është e ndarë në disa sektorë. Industria përpunuese e grurit në Kosovë është mjaft e konsoliduar, me 22 përpunues (mullinj), me një kapacitet vjetor prej 113,120 tonelatash. Prodhimi vjetor i misrit është 328,174 tonelata dhe kryesisht përdoret si ushqim për kafshë. Elbi, nga ana tjetër, kultivohet për prodhimin e birrës. Shuma vjetore e prodhimit të elbit është 11,000 tonelata. Prodhimi vendor i perimeve të përpunuara arrin 30% të nevojave të tregut. Kapacitetet e industrisë përpunuese të frutave aktualisht janë të ulëta (vetëm 14%). Kërkesat e tregut lokal për fruta të përpunuar mbulohet nga importi. Kosova ka 12 fabrika përpunuese të mishit, të cilat ofrojnë prodhim ditore prej rreth 90 tonelatash. Këto objekte përpunojnë 2,900 tonelata mish që përbën vetëm 15% të prodhimit vjetor. Si rezultat i numrit të vogël të kafshëve për prodhimin e mishit nga fermat e vendit, përpunuesit e mishit importojnë 85% të lëndëve të para. Industria e prodhimit dhe e përpunimit të qumështit paraqet një sektor mjaft të rëndësishëm të ekonomisë së Kosovës. Aktualisht në Kosovë punojnë 26 fabrika përpunuese të qumështit, të cilat, përveç qumështit, prodhojnë jogurt, kos, djathë, kaçkavall etj. Edhe pse ka numër të madh të fabrikave të qumështit, mbi një e katërta e përgjithshme e konsumit të produkteve të përpunuara të qumështit mbulohet nga importi. (Ragip Kastrati)

INDUSTRIALIZIMI. Fazë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik, e cila çon në rritjen e ndjeshme të rolit të industrisë në ekonominë e një vendi. Kosova ka kaluar një proces specifik të industrializimit në krahasim me vendet europiane dhe, deri diku, edhe në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore. Fillet e industrializimit në Kosovë gjenden në fund të viteve ‘20 të shekullit XX, kur nis eksploatimi dhe shkrirja e xehes në Trepçë. Industrializimi merr një nxitje me ndërtimin e fabrikave të

para të tekstilit dhe të përpunimit të ushqimit në fund të viteve ‘50 dhe fillim të viteve ‘60 të shekullit të kaluar dhe pastaj fuqizohet ndjeshëm në vitet ‘70, kur janë ndërtuar kapacitetet industriale në të gjithë qendrat urbane më të mëdha të Kosovës. Në fund të kësaj periudhe industria mori rolin kryesor në transformimet ekonomike e sociale të vendit, duke krijuar rreth 45 për qind të vlerës së produkteve dhe të shërbimeve. Industrinë e Kosovës e ka dominuar industria e metaleve me ngjyra, si plumbi, zinku, ferro-nikeli, pastaj prodhimi i energjisë elektrike, përpunimi i metaleve, industria ushqimore, industria e tekstileve dhe e materialit ndërtimor. Industrializimi i vonuar i Kosovës, në krahasim me entitetet e tjera të ish-federatës Jugosllave dhe financimi i këtij zhvillimi kryesisht me kredi (për dallim nga entitetet e tjera, që fillet e zhvillimit i kishin bazuar në grante zhvillimore), pastaj edhe pozita jo e mirë e sektorëve kryesorë industrialë në tregun unik jugosllav (sidomos në regjimin e tregtisë së jashtme dhe në sistemin e çmimeve), sikundër dhe niveli i ulët i përpunimit dhe i zhvillimit të industrive të produkteve finale, konsiderohen si shkaktarët kryesorë të prapambetjes ekonomike të Kosovës në ish-Jugosllavi.

Industrializimi i mëtejshëm në Kosovë u ndërpre dhunshëm pas vitit 1989 dhe përcillet me vështirësi të mëdha edhe aktualisht. Një proces specifik i riindustrializimit po zhvillohet me shumë vështirësi viteve të fundit, i ndikuar nga mjedisi i papërshtatshëm për investime (kreditë e shtrenjta, konkurrenca e ashpër nga importi dhe mungesa e politikave adekuate industriale). Edhe ky zhvillim përcillet me një diskontinuitet në krahasim me strukturën e krijuar industriale në vitet ‘70 e ‘80 të shekullit të kaluar. Kryesisht janë vënë në funksion ndërmarrje të vogla dhe të mesme private nga fusha e prodhimit të materialit ndërtimor, të prodhimit të ushqimit dhe të pijeve, të industrisë së drurit, si dhe nga industria e shërbimeve në fushën e telekomunikimeve dhe të teknologjisë informatike. (Muhamet Mustafa)

INFLACIONI. Ngritja e përgjithshme e çmimeve për produkte dhe shërbime në një vend të caktuar për një periudhë të caktuar kohore, zakonisht për një vit. Sa më shumë që ngrihen çmimet, aq më shumë do të bjerë

vlera e parasë. Vlera e parasë matet me sasinë e produkteve dhe shërbimeve që ajo mund të blejë. Në dekadën e fundit shumica e vendeve të zhvilluara janë munduar të mbajnë inflacionin në limitet nga 2 deri në 3%. Edhe ekonomia e Kosovës, viteve të fundit, është karakterizuar me inflacion të ulët. Gjatë vitit 2014 në Kosovë norma e inflacionit ishte 0.4%. Inflacioni në Kosovë prezantohet nga Enti i Statistikave të Kosovës, i cili mat inflacionin përmes indeksit të çmimeve të konsumit. Inflacioni pritet të mbetet i ulët edhe në periudhën afatmesme, nga 0.2% në vitin 2015 deri në mesataren 0.5% në periudhën 2016-2017. (Alban Zogaj)

INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE NË LUGINËN E PRESHEVËS. Për shkak të rrethanave politike, ekonomike dhe social-kulturore, rajoni i Luginës së Preshevës nuk kishte një traditë në fushën e medie. Informimi i shqiptarëve në këtë rajon është bërë kryesisht përmes medie nga Kosova, nga Radiotelevizioni i Prishtinës dhe gazetaret ditore të asaj kohe, që dilnin në Prishtinë. Në fillim të vitit 1990 në Preshevë u themeluan subjektet e para politike shqiptare, të cilat i fituan zgjedhjet dhe krijuan mundësinë për të qeverisur me komunën e Preshevës. Kjo komunë më 1991 themeloi organin e saj për informim në gjuhën shqipe, gazetën periodike “Zgjimi” (1992-1996), e cila dilte në kuadër të Shtetësisë së Kulturës “Abdullah Krashnica” në Preshevë, si dhe revistën partiakë “Veprimi”, e cila dilte në kudër të Partisë për Veprim Demokratik në Preshevë. Fletushka “Jehona” nis të botohet më 1982, por pushon të dalë pas 11 numrave, sërish vazhdoi botimin më 1992, si revistë informative politike e përmuajshme. Gjatë viteve të luftës në Kosovë (1998/99) e më pas edhe në Luginën e Preshevës (2000-2001), ky rajon ishte pa mjete të informimit. Radio “Zëri i lirisë” ishte medie, nga e cila dëgjoheshin lajmet për luftimet dhe gjendjen politike në Luginën e Preshevës. Pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc (UÇPMB) këtë stacion mobil gjatë luftimeve e bartnin nga një pikë në tjetrën, duke iu shmangur sulmeve të forcave serbe. Pas arritjes së paqes, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE) themeloi tri medie lokale në komunat e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës. Në Preshevë nis Radiotelevizioni i Preshevës, në

Bujanoc Radiotelevizioni i Bujanocit dhe në Medvegje, Radio Medvegja. Radio Medvegja transmeton program të shkurtër në gjuhën shqipe. Në vitin 2001 u themelua medie private Radio “Toni” në Bujanoc, e cila dy vjet më pas u bashkua me RTV “Spektri” po në Bujanoc, ndërsa me 2006 nis të emitojë program RTV “Aldi” në Preshevë. Ndërkohë, revista “Jehona” rinisi botimin në Bujanoc që pas Marrëveshjes së Konçulit, por në mungesë të fondeve pushoi së botuari. Në vitin 2005 nis botimi i revistës informative-politike “Perspektiva”, në kuadër të Bashkësisë kulturore shqiptare po me këtë emër. Revista vazhdon të botohet çdo javë. Në vitin 2011, pas konstituimit të Këshillit Nacional Shqiptar, themelohet gazeta e përjavshme “Nacionali”, si organ i këtij Këshilli. Pas botimit të 152 numrave, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Serbisë, për shkak të mospajtitit me politikën redaktuese të gazetës, ia ndërpret financimin. Reformat në legjislacionin e Serbisë për informimin kanë kushtëzuar privatizimin e medie publike, të cilat kishin si themelues qeveritë lokale. Ky fakt ka dëmtuar informimin në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Ndërkohë, mediet e pavarura private përballen me vështirësi të shumta materiale, për shkak të tregut të kufizuar. Në këto rrethana, cilësia e informimit shqip në Luginën e Preshevës ka shumë mungesa. Informimi i qytetarëve bëhet kryesisht përmes portaleve të palicencuara, si dhe rrjeteve sociale. Ndërkohë, medie më të besueshme për opinionin konsiderohen mediet nacionale të Kosovës dhe Shqipërisë, të cilët shqiptarët në Luginë të Preshevës i ndjekin përmes operatorëve lokalë kabllorë dhe përmes internetit. (Zija Rexhepi)

INFORMIMI NË GJUHËN SHQIPE NË MAL TË ZI. Medie e parë në gjuhën shqipe në Mal të Zi, e cila u paraqit pas Luftës së Dytë Botërore ishte Radio-Titogradi. Në kuadër të kësaj radioje, emisioni i parë shqip u transmetua në vitin 1949, por pas pak muajsh u shua, për t’u rikthyer sërish në vitin 1965. Programi informativ gjysmë ore në gjuhën shqipe udhëhiqej nga Gjergj Gjokaj, krahas të cilit punonte edhe gazetari Mirash Gojçaj. Që nga vitet 1980 në Ulqin filloi punën radioja lokale, e cila finançohej nga qeveria vendore. Radio-Ulqini udhëhiqej nga Muzafer Belo Çausi, ndërsa gazetar ishte Esat Mehmeti. Edhe Radio-Tivari transmetonte një emision informativ



GAZETA "KOHA JAVORE", PODGORICË

ditor në gjuhën shqipe. Redaktore ishte Drane Gjokvuçiq, e diplomuar për gjuhë dhe letërsi shqipe. Krahas radiove që financoheshin nga burime qeveritare, pas vitit 2000 filloi edhe ngritja e medieve elektronike private, të cilat në skemën e tyre kanë programe informative, arsimore dhe argëtuese. Ndër mediet më të njohura private radiofonike dhe vizive ndër shqiptarët në Mal të Zi janë: Televizioni BOIN (Tuz), me kryeredaktore Sandra Bojën; Televizioni "Teuta" (Ulqin), kryeredaktore Ilmira Lika; si dhe "Radio Elita", po kështu në Ulqin, me kryeredaktore Vera Katanën. Në kuadër të Radio-Televizionit të Malit të Zi transmetohen dy emisione informative ditore në gjuhën shqipe nga 15 minuta, si dhe dy kronika javore dhe dy emisione informative në Radiotelevizionin e Malit të Zi. Redaksia në gjuhën shqipe në TV-Podgoricë udhëhiqet nga Fran Camaj, ndërsa në Radio-Podgoricë nga Petar Lucoviq.

Në informimin shqip në Mal të Zi, në periudhën 1990-2000 kanë luajtur rol të rëndësishëm korrespondentët e medieve elektronike dhe të shtypura kryesisht nga Ulqini dhe viset e banuara me shqiptarë, si: Ibrahim Berjashi ("Rilindja", Radio-Tirana, Radio-Shkupi), Islam Pali ("Koha ditore"), Haxhi Shabani (Qendra për Informim e Kosovës), Zenel Katana (BBC), Vera Katana (DW), Asllan Bisha (Radiotelevizioni i Kosovës), Ali Salaj ("Zëri i Amerikës"), Rexhep Çunmulaj (Radio Kosova), Gjokë Dukaj (REL) etj.

Ndryshe nga mediet elektronike, mediet e shtypura në gjuhën shqipe në Mal të Zi u zhvilluan më vonë. Gazeta e parë mujore në gjuhën shqipe në Malin e Zi ishte "Fati" (1994), të cilën e botuan një grup shkrimtarësh dhe

gazetarësh shqiptarë, kryesisht nga Ulqini. Në vitet '90 në Ulqin u botua edhe gazeta "Kronika", pastaj gazeta "Shpresa" (1998), e cila iu dedikua refugjatëve të Kosovës etj. Nxitjen më të madhe informimi shqip në Mal të Zi e mori me gazetën "Koha javore", e cila filloi të botohej nga shkurti i vitit 2002, në fillim nga Shtëpia botuese dhe informative "Pobjeda" e Podgoricës dhe më vonë në Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve. Përveç redaktorit përgjegjës Ali Salaj, në redaksinë e kësaj gazete punojnë edhe dy gazetarë (Ismet Kallaba dhe Tonin Ujkaj). Pas viteve '90, në hapësirën kulturore-informative në gjuhën shqipe në Mal të Zi u shfaqën edhe disa të përkohshme kulturore, si: "Buzuku", "Malësia", "Kraja", "Lemba", "Dija" etj.

Forma më e re e teknologjisë së komunikimit masiv, portalet dhe sistemet online janë bërë shumë të vizituara dhe të lexuara edhe nga shqiptarët në Mal të Zi. Në Ulqin ka selinë gazeta ditore online "Ul-Info" me kryeredaktor gazetarin Mustafa Canka, pastaj "Malesia.org", me seli në Tuz, me kryeredaktor Robert Camajn etj. (Ibrahim Berjashi)

INFORMIMI NË KOSOVË. Politika koloniale që u zbatua nga Perandoria Osmane dhe nga Mbretëria e Serbisë dhe e Jugosllavisë pas vitit 1912, pastaj presioni politik, kontrolli dhe censura, si politika shtetërore ndaj gjuhës dhe komunikimit publik në gjuhën shqipe, bënë që informimi në Kosovë të paraqitet i vonuar dhe me pengesa të mëdha. Media e parë elektronike në Kosovë u shfaq në vitin 1927, kur u hap një radio në Mitrovicë, me mbështetjen e kompanisë angleze "Selection Trust Ltd.", e cila menaxhonte minierën e "Trepçës". Ndërkaq, nga fundi i vitit 1941 nis emetimi i programit nga Radio-Prizreni, që kishte fuqi transmetuese prej 200 vat. Në anën tjetër, nxënësit e gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë e zgjeruan rrjetin radiodifuziv në vitin 1942 me Radio-Kosovën, e cila kishte kapacitet transmetues prej 500 vat. Më 5 shkurt 1945 fillon transmetimi i programit të rregullt nga Radio-Prizreni në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Transmetimi i programit nga kjo radio transferohet në Prishtinë, me ç'rast ndërrohet dhe emrin në Radio Prishtina.

Programet e para televizive në Kosovë shihen nga viti 1959, ndërsa repetitori i parë instalohet në gusht të vitit 1963, në Fushën e Gjanë



PALLATI I SHTYPIT, PRISHTINË

(Veternik), në periferinë jugore të Prishtinës. Në Kosovë Televizioni i Prishtinës emeton program në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke nga nëntori i vitit 1975. Themelues i Radiotelevizionit të Prishtinës (RTP) ishte Kuvendi i Kosovës. Më 5 korrik 1990 RTP u pushtua nga forca të policisë serbe, të cilat hynë dhunshëm në lokalet e RTP-së. Ndërkohë, më 4 janar 1999 nga një radiostacion në malet e Berishës në Drenicë, Radio “Kosova e Lirë” bën transmetimin e parë eksperimental 5 minutash. Radio “Kosova e Lirë” gjatë luftës ishte transmetuese informative nga terrenet e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 19 shtator 1999, jo më si RTP, por me emrin Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), filloi të transmetojë programin që zgjaste dy orë. Në kuadër të RTK-së ishin edhe transmetuesit Radio Kosova dhe Radio “Blue Sky” (më vonë Radio Kosova 2). Nga mesi i vitit 2007, RTK-ja, që mori statusin e transmetuesit publik, krahas programit në gjuhën shqipe, transmetonte program edhe në katër gjuhë të minoriteteve: serbe, boshnjake, turke dhe rome. Krahas transmetuesit publik, në Kosovë u zhvilluan edhe mediet komerciale elektronike: RTV-21, Kohavision (KTV) dhe Radio-Dukagjini. Në fund të vitit 2001, në Kosovë ishin të paraqitura e të licencuara për punë 48 radio në gjuhën shqipe, 22 radio në gjuhën serbe, nga 2 radio në gjuhën turke dhe boshnjake dhe tri radio në gjuhën rome.

Fillet e shtypit në Kosovë nisnin në Prizren, në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, në Perandorinë Otomane. Më 1871 botohet gazeta “Prizren” në gjuhën serbe dhe turke dhe sallnameja e vilajetit të Kosovës me emrin “Kosova”, botim në gjuhën turke. Ndërkaq, botimi i mirëfilltë i medieve të shtypura në Kosovë fillon pas Luftës së Dytë Botërore, veçmas në gjuhën shqipe. Më 12 shkurt 1945 botohet numri i parë i gazetës “Rilindja”. Nga viti 1948 deri më 1957 kjo gazetë botohet dy herë në javë, ndërsa nga nëntori i vitit 1958 del si e përditshme. Po më 1945 nis të botohet fletushka për rini, “Zani i rinisë”, pastaj nga viti 1946 fletushka për fëmijë, “Pionieri”, revista për letërsi “Jeta e re”, ndërsa “Shëndeti” nga viti 1953. Në vitet ’70 të shekullit XX, me zgjerimin e autonomisë së Kosovës, edhe shtypi përjeton zhvillim më të përshpejtuar. Krahas gazetës “Rilindja” në gjuhën shqipe, “Jedinstvo” në gjuhën serbe dhe “Tan” në gjuhën turke, nis botimi i revistës për kulturë dhe art “Fjala”, për arsim “Shkëndija”, për bujqësi “Bujku”, për humor “Thumbi”, për gra “Kosovarja”, të gjitha këto në kuadër të Ndërmarrjes Gazetare Botuese Grafike (NGBG) “Rilindja”. Botohet edhe gazeta e studentëve të Universitetit të Prishtinës, “Bota e re”, e cila u themelua në vitin 1968. Kështu, në vitin 1985 në Kosovë botoheshin 42 revista javore, 3 njëmuajore, 5 dymujore, 2 tremujore. U botuan gjithashtu edhe një numër gazetash me përmbajtje politike-partiake, pastaj një numër gazetash të ndërmarrjeve prodhuese, përfshirë edhe të tilla që propagandonin ideologjinë e komunizmit jugosllav, siç ishte gazeta “Komunisti”, e cila kishte një edicion të veçantë për Kosovën, në gjuhën shqipe dhe serbokroate.

Situata e informimit në Kosovë ishte e varur nga rrethanat politike në ish-Jugosllavi, të statusit kushtetues të Kosovës dhe të drejtave të shqiptarëve në këtë shtet. Më ndryshimin e këtyre rrethanave në fillim të viteve ’90, ndryshon në mënyrë radikale edhe gjendja e medias në Kosovë. Kështu, me vendosjen e masave pushtuese të Serbisë në institucionet e Kosovës, përfshirë edhe ato të informimit, më 5 korrik 1990 u larguan nga puna 1,300 punëtorë të RTP-së dhe rreth 1,600 punëtorë të NGBG “Rilindja”, duke u ndërprerë me këtë rast edhe botimi i gazetës “Rilindja” dhe transmetimi i programit të RTP-së. Periudha vijuese, gjatë viteve ’90, ishte periudhë e të ashtuquajturit “terr informativ

në Kosovë”. Të gjitha mediet u vendosën nën kontrollin rigoroz të Serbisë, ndërsa mediet e pavarura nuk lejoheshin. Për të çarë këtë bllokadë informimi u gjetën disa zgjidhje alternative, siç ishte programi pesëminutësh i lajmeve të Radio-Zagrebti në gjuhën shqipe, programi satelitor i Radiotelevizionit Shqiptar, buletini ditor i Qendrës për Informim të Kosovës dhe radiot e huaja, si “Zëri i Amerikës”, BBC, “Dojçe Velle” etj. Ndërkohë, më 3 prill 1997 doli numri i parë i gazetës së pavarur “Koha ditore”, ndërsa gazeta tjetër e pavarur “Kosova sot” nisi botimin më 12 shtator 1998. Gjatë kohës së luftës, veçmas në periudhën e bombardimeve të NATO-s, pati një ekspansion të informimit të huaj për Kosovën, ndërsa kosovarët, të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, kishin burim informimi radiot e huaja në gjuhën shqipe, Radiotelevizionin Shqiptar, Radion “Kosova e lirë”, agjencinë “Kosovapress” etj.

Mbas qershorit të vitit 1999 në Kosovë nisën të botohen gazeta dhe revista, por të ballafaquara me kushte shumë të vështira pune. Botohen gazetate ditore: “Zëri”, “Epoka e re”, “Bota sot”, “Dardania”, “Dita”, “Gazeta shqiptare”, pastaj “Lajm”, “Infopress”, “Gazeta express”, “Illyria” dhe disa revista dhe të përkohshme të tjera. Përveç agjencisë “Kosovapress”, krijohen agjenci të reja informuese, si “Kosova live”, “Kosovanews”, “Telegrafi” etj. Së fundi në Kosovë janë shfaqur portalet dhe gazetate online, të cilat kanë zëvendësuar gazetate e shtypura. (Ibrahim Berisha)

INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS. Parti e komunitetit egjiptian në Kosovë, e themeluar pas luftës. Vepron në gjithë territorin e Kosovës dhe jashtë, duke u angazhuar për një shoqëri të qytetarëve të barabartë, në veçanti për pozitën e komunitetit egjiptian. Ka organet qendrore partiake, si: kuvendin e përgjithshëm, këshillin drejtues, kryesinë dhe kryetarin. Në nivelin lokal është e organizuar në degë dhe nëndegë, gjithashtu ka edhe forumin rinor dhe forumin e gruas. Si parti ka marrë pjesë gati në të gjitha zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale në Kosovë, është përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës me votat e fituara dhe me ulëset e rezervuara për komunitetet joshumicë. (Osman Ismaili.)

INICIATIVA QYTETARE “ORA”. Parti politike e themeluar në vitin 2004 nga publicisti

Veton Surroi. Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2004 kjo parti kishte arritur të siguronte 6.2% të votave dhe 7 nga 120 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Në programin e vet synonte një Kosovë të lirë, demokratike dhe të pavarur. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 fitoi 4.2% të votave, duke mos arritur të kalojë pragun zgjedhor prej 5%. Kjo bëri që themeluesi Surroi të jepte dorëheqje dhe të largohej nga partia, duke u zëvendësuar nga Teuta Sahatçija. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, “Ora” vazhdoi me rënien e elektoratit, duke i shtyrë udhëheqësit e kësaj partie të shkrihen në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). (Nerxhivane G. Dauti)

INSPEKTORIATI SANITAR I KOSOVËS.

Organ ekzekutiv i specializuar për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë sanitare në Kosovë, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik. Sipas ligjit në fuqi, Inspektorati Sanitar i Kosovës bën kontrollin e ushqimit, të duhanpirjes, të kushteve higjienike-sanitare të objekteve industriale-ushqimore, shëndetësore, hoteliere, të objekteve parashkolllore dhe shkolllore, të objekteve të kulturës, të sportit dhe rekreacionit, të objekteve publike, të objekteve ku ushtrohen veprimtari social-kulturore, kërkimore, shkencore etj. Është organ i specializuar, që kontrollon zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare në sektorin shtetëror, publik e privat në veprimtaritë e ushtruara nga persona fizikë e juridikë, vendës dhe të huaj. Inspektorati Sanitar ka këtë strukturë organizative: kryeinspektorin sanitar; inspektorët sanitarë qendrorë, inspektorët sanitarë komunalë dhe inspektorët sanitarë kufitarë. Deri në vitin 2009 funksionoi në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa me miratimin e Ligjit për ushqimin (Nr 02/L109), kjo strukturë iu bashkëngjiti Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinës dhe ka sektorin sanitar, veterinar dhe fitosanitar. (Ibrahim Tershnjaku)

INSPEKTORIATI SHËNDETËSOR. U themelua në vitin 2006. Sipas ligjit, Inspektorati Shëndetësor është organ i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ushtron mbikëqyrjen e jashtme profesionale të institucioneve shëndetësore, pa marrë parasysh pronësinë dhe formën e financimit. Mbikëqyrja profesionale ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe të kujdesit ndaj qytetarëve në

institucionet shëndetësore. Funkcionet kryesore të Inspektoratit Shëndetësor janë të ndihmojë institucionet shëndetësore, përmes ofrimit të informacioneve dhe këshillave, për mënyrën e zbatimit të akteve juridike në fuqi, të cilat rregullojnë kujdesin shëndetësor si dhe marrja e masave proporcionale korrigjuese dhe ndëshkuese për evitimin e parregullsisve dhe rreziqeve në kujdesin shëndetësor. Funkcionet shtesë janë identifikimi dhe bartja e problemeve nga terreni për vendimmarrësit në shëndetësi dhe pjesëmarrja në përpilimin e akteve juridike relevante që rregullojnë fushën e kujdesit shëndetësor. Pjesë e rëndësishme e punës është shkëmbimi i informatave me palët e tjera të interesit, përfshirë profesionistët shëndetësorë, pacientët, menaxherët shëndetësorë, inspektoratet e tjera, policia, media etj. Inspektorati udhëhiqet nga kryeinspektori shëndetësor, i cili i raporton ministrit të Shëndetësisë. (Ardita Braku)

INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT. Janë institucione të arsimit të lartë të themeluara nga kompani, fondacione apo truste, me vendqëndrim ose me zyrë të regjistruar në Kosovë, me programe studimi të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe të licencuara nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Mbështeten në ligjet e arsimit të lartë në Kosovë (2002 e 2011), si dhe në akte nënligjore. Numri i institucioneve të arsimit të lartë privat në Kosovë u rrit me shpejtësi sidomos nga vitet 2002 dhe 2003. Janë akredituar rreth 30 institucione të tilla me programe dhe emërtime të ndryshme. Shumica syresh janë aktivë, por ende janë në procesin e konsolidimit. (Dali Emrullahu)

INSTITUCIONET E KSA TË KOSOVËS. Institucionet qeverisëse të Kosovës në periudhën komuniste. Ato shprehnin pozitën kushtetuese-juridike të Kosovës sipas Kushtetutës së Jugosllavisë (1974). Emërtimet dhe funksionet e këtyre institucioneve ishin të ngjashme me ato të republikave, ndonëse jo në të gjitha fushat. Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës ishte organi më i lartë i pushtetit me funksionin kushtetutëdhënës dhe legjislativ. KSA e Kosovës kishte Kryesinë si organ kolegjal, kurse organ ekzekutiv i KSA të Kosovës ishte Këshilli Ekzekutiv. Mëvetësia e Kosovës në fushën financiare dhe ekonomike si dhe në

atë gjyqësore dhe të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë sigurohej nëpërmjet institucioneve përkatëse, si: Banka Popullore e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Prokuroria Publike e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Si pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave, institucionet e Kosovës ishin të përfaqësuara në organet dhe organizatat e Federatës. Njëkohësisht, Kosova merrte pjesë në realizimin e bashkëpunimit me organet dhe organizatat e shteteve të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, në kuadër të politikës së jashtme të ish-Jugosllavisë. Ndërsa strukturimi i Kosovës në kuadër të kornizave kushtetuese-juridike të Serbisë shprehte një pozitë dualiste jo vetëm nga aspekti formal-juridik, por edhe nga aspekti juridik-kushtetues. (Esat Stavileci)

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETË-QEVERISËSE TË KOSOVËS (2001-2008). Institucionet e Kosovës të formuara në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, në periudhën para pavarësismit të Kosovës. Vetë emërtimi i tyre “Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse” tregonte karakterin kalimtar të tyre si dhe pushtetin jo të plotë në raport me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Korniza Kushtetuese kishte hapur mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale në Kosovë, nga të cilat do të legjitimoheshin këto institucione të përkohshme vetëqeverisëse. Plot tetë vjet, 2001-2008, Kosova bashkëqeverisej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së dhe nga këto institucione të përkohshme. Korniza Kushtetuese përcaktonte këto institucione të përkohshme të Kosovës: Kuvendin, kryetarin e Kosovës, Qeverinë, gjykatat dhe institucionet e pavarura. Kuvendi i Kosovës ishte institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vetëqeverisjes së përkohshme të Kosovës, i përbërë nga 120 deputetë të zgjedhur, prej të cilëve 20 mandate të rezervuara për komunitetet joshqiptare. Kryetari i Kosovës përfaqësonte unitetin e popullit dhe garantonte funksionimin demokratik të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes. Kryetari i Kosovës zgjidhej me mandate 3-vjeçar, me votim nga Kuvendi i Kosovës (dhe jo në zgjedhje presidenciale), model që pastaj u bart edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Jo vetëm ky status, por edhe kompetencat tejet të reduktuara, disa prej

të cilave ushtroheshin në koordinim me PSSP-në e OKB-së, e bënin presidentin e Kosovës të asaj periudhe kalimtare një institucion simbolik. Qeveria, ndërkaq, ushtronte pushtetin ekzekutiv dhe zbatonte ligjet e miratuara nga Kuvendi, brenda fushës së përcaktuar të përgjegjësive të institucioneve të përkohshme të përcaktuar me Kornizën Kushtetuese. Edhe kjo dispozitë ishte limituese, sepse që në fillim të përshkrimit të fushëveprimit të qeverisë saktësisht përcaktohej kufiri deri ku mund të shkonte ajo në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv, sikundër edhe fakti se dy ministra në Qeveri duhej të ishin nga komunitetet joshqiptare, të gjitha këto dëshmonin se UNMIK- u kishte vendosur kufirin e kompetencave të këtyre institucioneve në varshmëri nga PSSP-ja e OKB-së. Me Kornizën Kushtetuese gjykatat ishin përgjegjëse për zbatimin e drejtësisë në Kosovë, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe institucionet e tjera të pavarura. Ky sistem gjyqësor, para pavarësisë së Kosovës, njihje Gjykatën Supreme, gjykatat e qarkut, gjykatat komunale dhe gjykatat për kundërvajtje. (Blerim Reka)

INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Institucionet e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 përmbloodhi të gjitha detyrimet që i përmbante propozimi i Ahtisarit, ku si struktura, ashtu dhe funksionet e institucioneve të Republikës së Kosovës, për shkak të pranisë ndërkombëtare dhe ushtarake, kishin karakter të veçantë. Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni kryesor, si organ ligjvënës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Presidenti i Republikës së Kosovës është kreu i shtetit dhe ai përfaqëson unitetin e popullit të Kosovës, si dhe garanton funksionimin kushtetues të institucioneve, është komandant suprem i FSK-së dhe ka edhe kompetenca të tjera, veçanërisht në fushën e emërimeve dhe të shkarkimeve. Qeveria e Republikës së Kosovës është bartëse e pushtetit ekzekutiv, e cila zbaton ligjet dhe aktet e tjera të Kuvendit dhe veprimtarinë e vet e ushtron brenda përgjegjësive të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje, përfshirë këtu edhe kompetencat e kryeministrit. Qeveria i përgjigjet Kuvendit. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat. Pjesa më e madhe e dispozitave që kanë të bëjnë me organizimin, juridiksionin, emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe Këshillin Gjy-

qësor të Kosovës është bartur gati në tërësi nga Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisarit (Aneksi IV). Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion i pavarur. Ai siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Prokurori i shtetit gjithashtu është institucion i pavarur me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për vepër penale. Emërohet dhe shkarkohet nga presidenti i Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me të. Forca e Sigurisë së Kosovës është autoriteti i sigurisë për Republikën e Kosovës. Policia e Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë. Avokati i Popullit mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Auditori i Përgjithshëm i Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar. Banka Qendrore e Kosovës është institucion i pavarur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përherëshëm përgjegjës për procesin e zgjedhjeve. Të gjitha autoritetet e Kosovës veprojnë në pajtim me detyrimet që kanë marrë përsipër në Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit (26 mars 2007). Ato, deri më 7 shtator 2012, bashkëpunonin me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar. Me Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 25, 7 shtator 2012) përfundoi mbikëqyrja ndërkombëtare. Personat e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, do të vazhdojnë t'i kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. (Esat Stavileci)

INSTITUCIONET PARASHKOLLORE. Institucione për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të moshës parashkollore: çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve, qendrat komunitare, paralelet parafillore. Çerdhet dhe kopshtet e para shtetërore të fëmijëve në Kosovë filluan të themelohen pas Luftës së Dytë Botërore,

por përfshirja e fëmijëve në institucione të tilla vazhdimisht ishte simbolike. Deri në vitin 1960 në institucione parashkollore me qëndrim ditor në Kosovë u përfshinë vetëm 1% e fëmijëve të moshës parashkollore dhe atë kryesisht në Prishtinë dhe në Prizren. Gjatë viteve 1976-1980 u themeluan më shumë institucione të tilla me qëndrim ditor, pastaj edhe gjysmëditor, ose në kuadër të shkollave fillore në qytete të Kosovës. Disa prej tyre u shndërruan në qendra për edukimin dhe arsimimin parashkollor. Në vitin 1955 filluan punën edhe kuadrot e para profesionale të kualifikuara në gjuhën serbe, ndërsa kuadri pedagogjik në gjuhën shqipe filloi të përgatitej nga mesi i viteve 1970, fillimisht në shkollën normale (drejtimi për edukatorë), pastaj edhe në Akademinë Pedagogjike në Gjilan. Megjithatë, përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore mbeti gjithnjë e kufizuar, arriti në 2-3%, qoftë për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme, qoftë për shkak të pagesës. Arsimi parashkollor-parafillor, sikurse tërë sistemi i arsimit në Kosovë filloi të ndryshojë nga vitit 1999, ku krahas institucioneve parashkollore publike (çerdhe, kopshte, paralele parafillore), u paraqitën edhe institucione të tilla private, qendra me bazë komunitetin. Ndërkohë është shtuar edhe numri i paraleleve parafillore për fëmijët nga mosha 5-6 vjeç. Janë bërë ndryshime edhe në filozofinë dhe kurikulën e edukimit të fëmijëve në këto institucione, sikundër që është rritur edhe përqindja e përfshirjes së fëmijëve. (Hajrullah Koliqi)

INSTITUCIONET TRANSITORE TË KOSOVËS (1999-2004). Institucionet e Kosovës të formuara menjëherë pas vendosjes së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Edhe emërtimi i tyre flet për karakterin e kalimtar në procesin e bartjes së kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët. Para hyrjes në fuqi të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, ekzistonte faza transitore e qeverisjes së UNMIK-ut, së bashku me institucionet transitore vendore. Mirëpo këto institucione transitore kishin karakter këshillëdhënës. Në vitet e para pas vendosjes së UNMIK-ut, me kompetencat ekskluzive të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe në mungesë të një legjitimiteti demokratik për qeverisje të vendorëve ishte inauguruar

një bashkëqeverisje e ndërkombëtarëve me vendorët. Liderët e partive kryesore politike në Kosovë ishin të përfaqësuar në Këshillin Transitor të Kosovës, të kryesuar nga PSSP i OKB-së, që në një mënyrë ishte një lloj “qeverie teknike”, por me autoritetin final të PSSP-së. Këshilli Transitor përfaqësonte rrafshin politik, ndërkaq për fusha të caktuara ishin themeluar departamentet, që duhej të luanin rolin e “ministrive” deri në zgjedhjet e para dhe konstituimin pastaj të institucioneve vetëqeverisëse. Në krye të çdo departamenti ishin dy bashkëkryesues (një ndërkombëtar i emëruar nga UNMIK-u dhe një vendor i emëruar nga partitë politike të Kosovës), ku fjalën përfundimtare e kishte bashkëkryesuesi ndërkombëtar. Vetëm më vonë, me themelimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës u kalua në fazën e bashkëqeverisjes së UNMIK-ut me institucionet vetëqeverisëse të Kosovës. (Blerim Reka)

INSTITUCIONI PARASHKOLLOR “FRIDRIH FROBEL”, PRIZREN. Institucion për edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore, themeluar në Prizren më 1907 nga motrat Mikelangjela dhe Sapienca Çoba nga Shkodra, me përkrahjen dhe ndihmën e Austro-Hungarisë. Ishte kopsht fëmijësh prej moshës 3-7 vjeç, me qëndrim gjysmëditor. Punonte në dy ndërrime. Programi i punës edukative përfshinte ushtrimet në të folurit, lojëra, këngë etj. Edukimi u zhvillua në gjuhën shqipe. Veproi deri në vitin 1934. (Hajrullah Koliqi)

INSTITUTI “RIINVEST”. Institucion kërkimor për zhvillimin ekonomik, i themeluar në vitin 1995 me synim që të promovojë mendimin modern ekonomik në Kosovë dhe të ndikojë në politikat ekonomike dhe zhvillimore. Themeluesit, një grup bashkëmendimtarësh nga Universiteti i Prishtinës, të udhëhequr nga prof.dr.Muhamet Mustafa, kishin për qëllim që, duke ndriçuar aspektet ekonomike të çështjes së pazgjidhur të Kosovës, të përmirësonin informacionin e fuqive vendimmarrëse dhe të ndikonin tek ato për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje. Studimi bazik i grupit të ekspertëve të “Riinvest-it”, “Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës”, i publikuar në vjeshtë të vitit 1998 është në të vërtetë një studim mbi pozitën koloniale të Kosovës dhe mbi kapacitetet e saj që të ndërtojë ekonomi

të qëndrueshme dhe të krijojë buxhet për një shtet të pavarur. Pas vitit 1999 “Riinvest-i” vazhdoi punën kërkimore, duke publikuar mbi 50 studime e raporte në gjuhën shqipe dhe angleze, për shumë aspekte të strategjisë dhe të politikave zhvillimore dhe mjedisit biznesor në Kosovë, duke demonstruar kompetencë profesionale dhe pavarësi nga grupet politike. Në 20-vjetorin e themelimit, “Riinvest-i” evidentonte rreth 100 projekte hulumtuese, gjetjet dhe rekomandimet e të cilave kanë bërë ndryshime pozitive në shoqërinë kosovare. Duke shfrytëzuar përvojën në punë trajnimi dhe edukimi, në vitin 2007 “Riinvest-i” themeloi edhe kolegjin me të njëjtin emër. Përgjatë dy dekadave të funksionimit Instituti “Riinvest” zgjeroi numrin e bashkëpunëtorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë emra të njohur shkencorë të fushës së ekonomisë nga Europa dhe SHBA-ja. Gjithashtu, edhe numri i organizatave partnere të “Riinvest-it” është zgjeruar nga viti në vit. Aktualisht në “Riinvest” janë të punësuar rreth 50 vetë. (Selman Selmanaj)

INSTITUTI ALBANOLOGJIK I PRISHTINËS (IAP). Institucion i pavarur publik kërkimor-shkencor, që merret me studime e hulumtime shkencore në fushat e albanologjisë.



INSTITUTI ALBANOLOGJIK I PRISHTINËS

U themelua më 1953. Në fillim kishte katër punonjës dhe një numër bashkëpunëtorësh të jashtëm. Drejtor ishte Elhami Nimani, ndërsa

drejtues i studimeve Selman Riza. Me vendim të organeve shtetërore u mbyll më 1955. U themelua sërish në rrethana të reja më 1967 me drejtor Fehmi Aganin. Në vitin 1977 IAP-i u vendos në ndërtesën e re. Pas demonstratave të vitit 1981 puna e institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës pati kufizime të shumta. Kjo situatë u reflektua edhe në veprimtarinë e IAP-it. Në kuadër të kufizimeve që u aplikuan ishte edhe ndërprerja e bashkëpunimit me institucionet shkencore të Shqipërisë. Kjo shkaktoi ndërprerjen e disa projekteve, siç ishin “Atlasi dialektologjik i të folmeve shqipe”, “Leksioni i shkrimtarëve shqiptarë” etj. Me gjithë pengesat dhe kufizimet, IAP-i e vazhdoi realizimin e projekteve shkencore. Në vitet ‘90 IAP pati vështirësi për funksionim. Puna në këtë institucion nuk u ndërpre as pas marrjes me dhunë të objektit (8 mars 1994).

Puna kërkimore-shkencore në IAP organizohet në pesë degë: gjuhësia, letërsia, historia, folklori dhe etnologjia, por edhe në sektorë që merren me fusha të veçanta (dialektologji, leksikologji, onomastikë, kulturë e gjuhës, letërsi gojore, etnomuzikologji, arkeologji). Aktualisht Instituti ka 34 punëtorë shkencorë dhe 15 administrativë-teknikë. Veprimtaria botuese e Institutit përfshin botimet e rregullta dhe ato të veçanta. Botimet e rregullta janë: “Gjurmime albanologjike” me tri seri (seria e shkencave filologjike, seria folklor dhe etnologji dhe seria e shkencave historike), dhe revista “Gjuha shqipe”. Në një periudhë kohore revista “Gjurmime albanologjike” është botuar edhe në gjuhën frënge, me punime të zgjedhura, me titullin “Recherche albanologique”. Nga viti 2008 tri seritë e revistës “Gjurmime albanologjike” publikohen në variantin elektronik në *Central and Eastern European Online Library*.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Institutit realizohet përmes projekteve shkencore, punëve hulumtuese në terren, hulumtimeve në arkiva, organizimit të tubimeve shkencore dhe nëpërmjet veprimtarisë botuese. Nga viti 2010 në IAP organizohet aktiviteti tradicional shumëdisiplinor “Java e albanologjisë”. Në bibliotekën e IAP-it gjendet një fond librash prej rreth 20,000 tituj, 130 dorëshkrime e fotokopje dhe rreth 17,000 revista të ndryshme. IAP-i ka sallën e ekspozateve, ku ekspozohen njësitë etnologjike. Deri më tani IAP-i ka botuar rreth 500 libra. (Naim Berisha)

INSTITUTI ARKEOLOGJIK I KOSOVËS (IAK). Institucion i pavarur kërkimor-shkencor arkeologjik i Kosovës. U themelua në vitin 2003, pas nismës së proceseve për themelimin e tij në vitin 2000. Zhvillon veprimtari në fushën e kërkimeve, të gërmimeve dhe të studimeve arkeologjike në gjithë territorin e Kosovës. Rezultatet e kërkimeve dhe studimeve arkeologjike të IAK-ut pasqyrohen në revistën periodike “Kosova arkeologjike”, si dhe në konferenca të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë Kosovës. Ndërkaq, veprimtaria e organizuar arkeologjike në Kosovë filloi pas themelimit të Muzeut të Kosovës (1949). (Arben Hajdari)

INSTITUTI BUJQËSOR I KOSOVËS (IBK). Institucion që merret me hulumtime dhe aplikime në lëmin e bujqësisë. Fillet e tij i gjejmë në vendimin e Këshillit Popullor të KAKM-së (1947), kur ishin themeluar dy stacione rajonale në Prishtinë dhe në Pejë. Nga këto njësi themelohet Instituti Krahinor për Bujqësi në Pejë (1949). IBK-ja kaloi nëpër disa faza riorganizimi. Në vitin 1973 riemërohet në Instituti Bioteknik dhe më 1981 integrohet në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë. Aktualisht është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural. Aktiviteti profesional e shkencor është i orientuar në disa drejtime: në mbrojtjen e bimëve, në analiza të farës me fushat testuese, në analizat e tokës dhe të ushqimit, pastaj në përdorimin e teknologjive të reja dhe në shërbimet profesionale për sektorin publik dhe privat. (Shukri Fetahu)

INSTITUTI EKONOMIK. Bërthamë shkencore e pavarur në nivel institucional, që i ka fillet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht në vitin 1973, kur u themelua Enti për Kërkime Ekonomike. Në vitin 1977 ky ent u zgjerua dhe u shndërrua në Institutin Ekonomik me seli në Prishtinë. Veprimtaria themelore e tij mbështetej në hartimin e koncepteve, të strategjive dhe të planeve zhvillimore, të programeve të investimeve dhe të analizave të tjera ekonomike. Instituti Ekonomik botonte revistën “Ekonomia”, e vetmja e këtij lloji në Kosovë, ku trajtoheshin probleme nga fusha e makroekonomisë dhe mikroekonomisë. Instituti botoi edhe një varg studimesh dhe

monografish nga fusha e zhvillimit ekonomik dhe mbante lidhje me qendra studimore edhe jashtë Kosovës. Në tetor të vitit 1991 organet serbe e larguan me dhunë këtë institucion nga lokalet e veta dhe tërë inventari dhe dokumentacioni u grabit dhe u shkatërrua nga udhëheqja e dhunshme e Fakultetit Ekonomik. Në periudhën 1991-1994, Instituti vazhdoi të zhvillojë veprimtarinë e vet, duke iu përshtatur rrethanave dhe kushteve të reja. Punëtorët e Institutit edhe në kushte të rënda të okupimit ruajtën vazhdimësinë e punës kërkimore-shkencore. Pas vitit 1994, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Këshilli Qendror për Financim mori përsipër financimin e Institutit. Tani ky institucion zhvillon një veprimtari krejtësisht modeste. (Myrvete Badivuku-Pantina)

INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS (IHMK). Institucion monitorues i elementeve dhe dukurive meteorologjike, të cilësisë së ujërave, të ajrit dhe të dheut në



POLIGONI METEOROLOGJIK I IHMK-SË

Kosovë. Veprimtaria hidrometeorologjike në Kosovë ka filluar më 1922, me vendosjen e një late (hidrometri), një limnigrafi në Drinin e Bardhë, si dhe të shtëpizës meteorologjike për matjen e elementeve meteorologjike, të pajisura me hygrometër dhe anemometër. Për pikën e njëjtë datojnë edhe matjet e para klimatologjike në Kosovë. Vjetari i parë meteorologjik u nxor më 1925. Rrjeti monitorues është shtrirë sipas rrjedhave ujore nëpër pellgje lumore, ndërsa stacionet për matjen e elementeve dhe dukurive meteorologjike sipas gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike. Rrjeti monitorues ka funksionuar në kuadër të Entit Hidrometeorologjik të Serbisë. Enti Hidrometeorologjik i Kosovës u themelua më 1986. Gjatë viteve 90 të shek.

XX edhe ky institucion ndau fatin e njëjtë me institucionet e tjera në Kosovë. Në vitin 2000 u themelua IHMK-ja, si institucion për monitorimin e elementeve dhe dukurive meteorologjike të cilësisë së ujit, të ajrit, të dheut, si dhe të mbrojtjes kundër breshrit. IHMK-ja ka këta sektorë: të meteorologjisë, hidrologjisë, laboratorit për analizat fiziko-kimike të ujit, të dheut dhe të ajrit. Aktualisht rrjeti monitorues i IHMK-së përfshin: 18 stacione meteorologjike, 65 stacione të reshjeve, 28 stacione hidrometrike, rrjetin e marrjes së ujit në 52 profile lumore, rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit në 12 stacione statike dhe 1 lëvizës. IHMK-ja vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor të Kosovës. (Sylë Tahirsylaj)

INSTITUTI I ANATOMISË PATOLOGJIKE.

Institucion i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë në fushën e anatomisë patologjike. Me themelimin e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë seksioni i patologjisë u shndërrua në Institut të Anatomisë Patologjike (1970), ndërsa lënda e anatomisë patologjike filloi të mbahej gjatë vitit shkollor 1971/1972. Për shkak të mungesës së kuadrit mësimor shqiptar, ligjëratat mbaheshin në gjuhën serbe. Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Tiranës, patologë nga Tirana mbajtën mësim disa vite me radhë në këtë institut. Në vitin 1971 u zgjodh asistenti i parë i kësaj lënde mësimore dhe më pas filloi plotësimi gradual me kuadro të specializuara, që rekrutoheshin nga radhët e studentëve të dalluar të Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 1989, para se të viheshin masat e dhunshme serbe, në këtë institut punonin 13 mjekë (prej mjekut në specializim e deri te profesori ordinar). Krahas tyre, në institut punonin edhe 6 laborantë dhe 5 ndihmësobducentë, si dhe punëtorë të tjerë ndihmës dhe administrativë. Sot Instituti i Anatomisë Patologjike është i pajisur mirë dhe funksionon brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në kuadër të të cilit është edhe katedra e anatomisë patologjike, si njësi mësimore e Fakultetit të Mjekësisë. (Lumturije Luci)

INSTITUTI I ANATOMISË. Institucion i lartë shkencor dhe edukativ-arsimor i Fakultetit

të Mjekësisë në Prishtinë. U themelua në vitin 1969, bashkë me fillimin e punës të Fakultetit të Mjekësisë. Kishte kushte modeste, i pajisur me mjete elementare për zhvillimin e procesit mësimor. Ligjëratat e parë u mbajt në janar të vitit 1970 në gjuhën serbokroate për studentët e mjekësisë së përgjithshme, shqiptarë dhe serbë. Në vitin 1974 filloi punën asistenti i parë, ndërsa në vitin 1980 u zgjodh docenti i parë për mësim në gjuhën shqipe. Me vendosjen e Institutit në lokalet e reja (1980) dhe me zgjedhjen e stafit vendor u krijuan kushte dhe mundësi më të mira për punë dhe veprimtari efikase si në planin arsimor ashtu edhe në planin kërkimor-shkencor dhe profesional-shëndetësor. Në Institutin e Anatomisë janë punuar dhe janë udhëhequr shumë punime të magjistraturës dhe të doktoratës, projekte dhe punime shkencore e profesionale. Me hapjen e programeve të reja në Fakultetin e Mjekësisë, në Institutin e Anatomisë ndjekin mësimin edhe studentët e stomatologjisë (1975), studentët e farmacisë (1996), të fizioterapisë (2001) dhe të infermierisë (2003). Në vitin 1991 nga organet e dhunshme serbe u largua nga puna i tërë kuadri arsimor i këtij institucioni, me çka u ndërpre edhe veprimtaria akademike, hulumtuese dhe shkencore e ekspertëve shqiptarë në këtë institut. Deri në fund të viteve '90, aktiviteti akademik detyrimisht u zhvillua në kushte shumë të rënda, në shtëpi-shkolla, ndërsa pjesa praktike u mbajt në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës. Pas përfundimit të luftës, stafi akademik i Institutit të Anatomisë i kthehet punës normale për studime themelore, specializime, doktorata dhe punës hulumtuese e shkencore. Aktualisht në Institutin e Anatomisë punojnë 6 profesorë të rregullt dhe 7 asistentë, që të gjithë në fazën përfundimtare të doktoratës. (Bajram Nuraj)

INSTITUTI I BLEGTORISË DHE I VETERINARISË.

U themelua me bashkimin e Entit për Veterinari në Prishtinë dhe Entit për Blegtori në Prizren (1962). Zhvillimit i këtij institucioni kaloi nëpër disa periudha: Në periudhën e parë (1962-1967) Enti për Blegtori dhe Veterinari i bashkohet Entit për Seleksionimin e Kafshëve dhe Kontabilitetin Amë dhe Qendrës për Mbarështimin Artificial e Luftimin e Sterilitetit të Kafshëve Shtëpiake; në periudhën e dytë (1969-1974) bëhet themelimi i Institutit për Kërkime Shkencore

në Bujqësi dhe Veterinari, i cili në vitin 1973 merr emrin Instituti Bioteknik; në periudhën e tretë (1974-1981) themelohet Fakulteti i Bujqësisë në Prishtinë dhe në periudhën e katërt (1981-1987) bëhet bashkimi mes Fakultetit të Bujqësisë dhe Institutit Bioteknik në një organizatë punuese. (Xhevat Domi)

INSTITUTI I FARMAKOLOGJISË. Institucion i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i fushës së farmakologjisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. U themelua në vitin 1973 dhe një kohë funksionoi në kushte jo të përshtatshme për shkak të mungesës së kuadrit, të hapësirës së përshtatshme dhe të laboratorëve. Mësimi në gjuhën shqipe për disa vite me radhë u mbajt nga pedagogët e Universitetit të Tiranës. Me kohë nga radhët e studentëve të diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë u rekrutuan kuadro të reja, të cilët dhanë kontribut të çmuar në avancimin e punës profesionale dhe kërkimore në këtë fushë. Ata u specializuan në qendra të ndryshme universitare të ish-Jugosllavisë dhe në botën e jashtme. Punë e mirë në këtë institut u bë në studimin e farmakologjisë të sistemit nervor vegjetativ dhe atij qendror, sistemit urogenital, sistemit respirator dhe atij kardiovaskular, të farmakologjisë së hormoneve dhe farmakoterapisë së sëmundjeve ngjitëse. Parveç kësaj, kuadri i punësuar në këtë institut hartoi një varg tekstesh universitare, që ndihmuan studimet bazë dhe ngritjen profesionale të kuadrit të specializuar nga kjo fushë. Vendosija e Institutit të Farmakologjisë në godinë të re krijoi kushte më të mira të punës dhe ndikoi ndjeshëm në ngritjen e cilësisë së punës arsimore dhe kërkimore-shkencore. Aktualisht në këtë institut punojnë 4 profesorë dhe 2 asistentë. Në këtë institut ushtrohet edhe farmakologjia klinike, në bashkëpunim me Agjencinë e Barnave dhe Produkteve Mjekësore të Kosovës. (Rexhep Hoxha)

INSTITUTI I FILOZOFISË DHE I SOCIOLOGJISË. Njësi kërkimore shkencore e katedrës filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. U themelua në fund të viteve '70 për hulumtime empirike nga fushat e shkencave shoqërore. Drejtorë të tij ishin Fehmi Agani, Ali Dida dhe Gjergj Rrapi. Ndër projektet e para që i realizoi ky institut ishte hulumtimi "Pozita e gruas në

shoqëri" (1982), pastaj "Migrantët ditorë në Kosovë" (1985). Instituti ishte i përfshirë në projekte hulumtuese të realizuar në hapësirën e ish-Jugosllavisë, ndër të cilët më i rëndësishmi ka qenë hulumtimi "Struktura e shoqërisë jugosllave" (1988-1989), bartës i të cilit ishte Instituti i Shkencave Shoqërore i Universitetit të Lubjanës. Pjesa e këtij hulumtimi për Kosovën është quajtur "Struktura e shoqërisë kosovare". Gjatë viteve '90, si edhe i gjithë Universiteti i Prishtinës, Instituti zhvilloi veprimtarinë e tij jashtë objekteve zyrtare. Gjatë asaj kohe realizoi disa anketa në terren. Pas vdekjes së drejtorit të fundit, Gj. Rrapi, Instituti pushoi së vepruari. (Shemsi Krasniqi)

INSTITUTI I FIZIOLOGJISË PATOLOGJIKE. Si pjesë e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë filloi punën në vitin 1971. Që nga themelimi zhvilloi bashkëpunim intensiv me qendrat e tjera universitare të rajonit. Në vitin 1974 filloi punën laboratorit për ekzaminim funksional të sistemit respirator te pacientët dhe i njësisë hulumtuese eksperimentale në materialin shtazor. Kishte dy shërbime: sektorin e izotopeve radioaktive dhe shërbimin e transfuziologjisë dhe hematologjisë. Duke qenë e lidhur ngushtë puna e këtij instituti me emrin e dr. Musa Haxhiut, Instituti i Fiziologjisë Patologjike vendosi marrëdhënie bashkëpunimi me qendra universitare të Europës dhe të SHBA-së. Kjo u reflektua në mënyrë të veçantë në ngritjen e kuadrit shkencor dhe specializimin e tij profesional (kuadër biomjekësor, biologë etj.). Deri në vitin 1990, Instituti i Fiziologjisë Patologjike shënoi përparim të vazhdueshëm. Në prill të vitit 1991, nga regjimi serb shumica e punëtorëve të Institutit të Fiziologjisë Patologjike u përjashtuan nga puna. Disa prej tyre u larguan jashtë vendit. Pas përfundimit të luftës së Kosovës, puna në Institut dhe katedër rifilloi me shumë peripeci. Me ndihmën e donatorëve të ndryshëm, u arrit përtëritja laboratorëve hulumtues dhe eksperimentalë, të cilët vihen në shërbim të studiuesve shkencorë. Sot Instituti i Fiziologjisë Patologjike ka tre profesorë, shtatë asistentë të rregullt, disa të angazhuar, laborantë etj. Funksionon në kuadër të Fakulteti të Mjekësisë dhe të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe kryen veprimtari arsimore, shëndetësore dhe hulumtuese shkencore. (Halil Ahmetaj)

INSTITUTI I FIZIOLOGJISË. Institucion i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Fakultetit të Mjekësisë në fushën e fiziologjisë humane. U themelua në vitin 1970. Mësimi i lëndës së fiziologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë filloi gjatë vitit shkollor 1970/71, ndërsa për studentët e stomatologjisë, fiziologjia me biokimi në vitin shkollorë 1976/77. Fillimisht mësimi u mbajt në gjuhën serbokroate, me profesorë nga Beogradi. Më pas mësimin në gjuhën shqipe për disa vjet e mbajtën profesorë të Universitetit të Tiranës. Deri në vitin 1990 Instituti i Fiziologjisë, që punonte në kuadër të shërbimit të instituteve, ishte bërë qendër me interes për hulumtime shkencore. Instituti ishte i pajisur me teknologji dhe aparaturë moderne, gjë që mundësonte realizimin e projekteve të ndryshme. Përveç me punë edukative-arsimore dhe shkencore, Instituti i Fiziologjisë merret edhe me veprimtari shëndetësore, duke bërë hulumtime bashkëkohore në lëmin e fiziologjisë humane. Shumica e analizave hormonale, enzimatika dhe analizat e tjera me interes nga kjo fushë janë bërë në këtë institut. Aktualisht Instituti i Fiziologjisë funksionon në kuder të Qendrës Klinike Universitare dhe të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. (Natyra Karahoda)

INSTITUTI I HISTOLOGJISË. U themelua në vitin 1970. Në fillim, nga viti 1971 ligjëratat në gjuhën shqipe nga kjo lëndë i mbanin profesorët e Universitetit të Tiranës. Në vitin 1972 u zgjodh asistentja e parë shqiptare nga lënda e histologjisë (Asene Agaj). Mësimin për studentët serbë e mbanin profesorët nga Universiteti i Beogradit. Më vonë për mbajtjen e ushtrimeve u pranuan edhe asistentë të rinj. Si në të gjithë institucionet e tjera, në vitet '90 u ndërpre puna e Institutit, por rinisi menjëherë pas luftës dhe çlirimit të vendit. Sot Instituti i Histologjisë është i pajisur me teknologji bashkëkohore dhe merret me hulumtime profesionale dhe shkencore. Në të zhvillohet mësimi praktik dhe teorik për lëndën e histologjisë për studentët e Fakultetit të Mjekësisë, të Stomatologjisë, të Fizioterapisë dhe të Farmacisë. Kuadrin arsimor e përbëjnë dy profesorë dhe katër asistentë. Hapësira e punës i përmbush standardet. Ekspertët e këtij Instituti kanë botuar një mori punimesh shkencore dhe profesionale dhe dhjetëra tekste universitare. Kanë zhvilluar bashkëpunim të

frytshëm me institutet e ngjashme në rajon, në Europë dhe Amerikë. Në kuadër të Institutit funksionon katedra e histologjisë e Fakultetit të Mjekësisë. (Remzije Belegu).

INSTITUTI I HISTORISË SË KOSOVËS, PRISHTINË. Institucion kërkimor-shkencor, që merret me studimin e historisë së popullit shqiptar që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. U themelua si Ent i Historisë së Kosovës më 1967, me vendim të Kuvendit të Kosovës, me synim që të merrej me studimin e historisë së lëvizjes punëtore dhe komuniste. Më 1980 u shndërrua në Institut të Historisë, kurse nga viti 1992 si Institut i Historisë i Republikës së Kosovës. Që nga viti 1971 botoi revistën "Kosova", e cila deri sot doli në 40 numra. Instituti i Historisë së Kosovës, në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë, nga viti 1993 botoi në anglisht revistën historiko-politike "Kosova", ndërsa organ i Institutit ishte edhe revista "Në flakën e revolucionit", që u botua shqip dhe serbisht, nga viti 1971 deri më 1990, gjithsej 11 numra.

Instituti ka arkiv të pasur me kopje dokumentesh të sjella nga arkivat e huaja dhe një bibliotekë me literaturë historike. Puna shkencore e studiuësve të këtij instituti, përveç se në revista, është pasqyruar në monografi, botime të veçanta, përmbledhje studimesh e artikujsh të botuar në Kosovës dhe jashtë saj, si dhe me botimin e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar. Pas demonstratave të vitit 1981, Instituti u vendos në shënjestër të sulmeve antishqiptare dhe të procesit të diferencimit ideopolitik, të organeve shtetërore, të shtypit dhe të mjeteve të tjera të informimit në ish-Jugosllavi. Punonjësit e tij u akuzuan për nacionalizëm dhe irredentizëm. Më 1990, Kuvendi i Serbisë ndërpreu me dhunë punën e Institutit të Historisë së Kosovës, një herë duke vendosur masat e dhunshme administrative me drejtues serbë, ndërsa një vit më vonë Kuvendi i Serbisë vendosi mbylljen e tij. Pas këtij vendimi, punonjësit shqiptarë të Institutit u vetorganizuan dhe vazhduan punën dhe për 10 vjet arritën ta ruajnë vazhdimësinë e punës shkencore. Kontributin për shkencën e historisë Instituti e ka dhënë me organizimin e mbi 60 sesioneve dhe konferencave shkencore, të 40 numrave të revistës shkencore "Kosova", të 8 numra të revistës historiko-politike "Kosova" në gjuhën angleze dhe shqipe, të rreth 100

monografive dhe botimeve të veçanta, si dhe të shumë kontributeve të tjera të publikuara në revistat dhe gazetat e përditshme brenda dhe jashtë vendit. Që nga themelimi zhvilloi bashkëpunimin me institucionet shkencore të Kosovës dhe të republikave të ish-Jugosllavisë, ndërsa pas vitit 1990 edhe me institucione shkencore të Shqipërisë. (Fehmi Rexhepi)

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS (IKMN). Institucion profesional për ruajtjen e natyrës dhe monitorimin e gjendjes së vlerave të mbrojtura natyrore në Kosovë. Në fillim u formua si njësi e veçantë në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës (1968), ndërsa më vonë si ent, veprimtaria e të cilit u përcaktua me ligj (1988). U bë funksional si Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës (2000), me seli në Prishtinë, ndërsa me riorganizimin institucional (2006), IKMN-ja kalon nën Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Me ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (2010), të gjitha punët profesionale për mbrojtjen e natyrës janë kompetencë e këtij Instituti. IKMN-ja realizon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për mbrojtjen e natyrës; harton plane afatgjata për mbrojtjen e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, ekosistemeve, peizazheve etj.; monitoron gjendjen e larmisë biologjike dhe të peizazheve; merret me mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës (vlerave natyrore); definon kushtet e mbrojtjes së natyrës, si dhe bën menaxhimin e zonave të mbrojtura. IKMN-ja harton raportet për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës dhe është bashkëpjesëmarrëse në zbatimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës. (Fadil Bajraktari)

INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE. Institucion i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës në fushën e mjekësisë ligjore. Shërbimet mjekoligjore në Kosovë e kanë fillin në vitin 1963; ato janë kryer në bodrumin e ndërtesës së vjetër të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës (në kuadër të shërbimit të anatomisë dhe të patologjisë). Në fillim punohej në kushte të vështira, sepse mungonte infrastruktura hapësinore dhe kuadri, kurse mundësitë diagnostike ishin të kufizuara.



INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE, PRISHTINË

Lënda e mjekësisë ligjore filloi të mësohet në vitin shkollor 1974/75 dhe ligjërues i parë ishte dr. Fadil Batalli. Në këtë institut punonte edhe ekipi serb. Në vitet '90 në këtë institut punët mjekoligjore i kryenin ekipet serbe, meqë shqiptarët ishin nxjerrë nga puna. Pas luftës puna filloi rishtas. Në vitin 2002 u krijua edhe zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore në kuadër të ish-Departamentit të Drejtësisë, e cila funksionoi paralelisht me Institutin e Mjekësisë Ligjore deri në vitin 2009. Në këtë vit u themelua departamenti i mjekësisë ligjore, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, duke unifikuar Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe zyrën e mëparshme për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore. Aktualisht departamenti i mjekësisë ligjore është i vetmi institucion në Republikën e Kosovës që ofron shërbime profesionale mjekoligjore në tërë territorin e saj, shërbime që përfshijnë komponentin profesional, shkencor-hulumtues dhe edukativ-arsimor. (Flamur Blakaj)

INSTITUTI I MJEKËSISË SË PUNËS, GJAKOVË. Institucioni i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor, bazë mësimore e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë në fushën e mjekësisë së punës. Me themelimin e Fabrikës së Tekstit në Gjakovë (1958) filloi punën ambulanca mjekësore për përkujdesje ndaj punëtorëve të kësaj fabrike (1961). Ambulanca funksionoi deri më 1982 kur u ndërtua objekti i ri, Dispanseri i Mjekësisë së Punës. I pajisur me kabinete dhe aparaturë moderne diagnostike, funksionoi deri në vitin 1999, ku e tërë aparatura u plaçkit nga pushteti i atëhershëm serb. Pas luftës i gjithë stafi fillon punën pa mjete themelore. Në vitin 2000 Departamenti i Shëndetësisë këtë dispanserë e emërtoi Instituti i Mjekësisë së

Punës në Gjakovë, duke e pajisur me aparaturë bashkëkohore dhe me kabinetet përkatëse. Me Ligjin e shëndetësisë nr. 04/L-125 (1014) ky Institut mori emrin Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, nivel terciar, si njësi organizative dhe funksionale e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Qendra ka kabinete bashkëkohore dhe staf të përgatitur për otorinolaringologji, gjinekologji, oftalmologji, radiologji, kardiologji, dermatologji, pulmologji, diabetologji etj. Në këtë Institut janë të punësuar 18 mjekë specialistë të profileve të ndryshme, 36 infermierë etj. (Rifat Lila)

INSTITUTI I MJEKËSISË SË PUNËS, OBLIQ. Ishte institucion profesional-shkencor dhe edukativ-shëndetësor në lëmin e mjekësisë së punës dhe bazë mësimore e Fakultetit të Mjekësisë (1971-2000). Ishte organizatë shëndetësore e specializuar për mjekësinë e punës, sëmundjet profesionale, mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen nga rrezatimet radioaktive. U themelua në vitin 1963, fillimisht si Dispanseri e Mjekësisë së Punës, kurse në vitin 1990 mori emrin Enti i Mjekësisë së Punës, ndërsa nga viti 1999 u quajt Institut i Mjekësisë së Punës, duke ofruar edhe shërbime terciare dhe ishte qendër referente e mjekësisë së punës për Kosovë. Si themelues i këtij institucioni konsiderohet dr. Mehmet Begraca, i cili ambulancën e Kombinatit Energjetik “Kosova” e ngriti në nivel të dispanserisë së punës. Me hapjen e Fakulteti të Mjekësisë në Prishtinë, dispanseria bëhet Ent i Mjekësisë së Punës. Kishte pajisje bashkëkohore dhe udhëhoqi shumë projekte të karakterit ndërkombëtar. Luajti rol të rëndësishëm në aftësimin e kuadrit mjekësor në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Në të punuan shumë profesionistë, si internistë, oftalmologë, gjinekologë, pneumoftziologë, radiologë etj. Sot Institut i ka karakter publiko-privat dhe luan një rol me interes për lëmin e mjekësisë së punës. (Merita Berisha)

INSTITUTI I PLUMBIT DHE I ZINKUT, MITROVICË. U themelua në vitin 1966 në kuadër të kombinatit “Trepça”, me qëllim të bashkimit të proceseve prodhuese me punën kërkimore-shkencore. Bërthamat e para (byrotë) për përparimin e proceseve të prodhimit ishin krijuar qysh në vitin 1956, si njësi të veçanta organizative. Në vitin 1961, duke u bashkuar këto njësi në “Trepçë”, u



INSTITUTI I PLUMBIT DHE I ZINKUT, MITROVICË krijua Qendra për Xehetari në Stantërg dhe Qendra për Metalurgji në Zveçan, të cilave më 1961 iu bashkua byroja e projekteve (1961), duke krijuar Qendrën për Punë Shkencore Kërkimore, si paraardhëse e Institutit të Plumbit dhe të Zinkut. Institut i funksionoi deri në vitin 1971, kur u suprimua për shkaqe politike: e para, sepse me zhvillimin e mëtejshëm të punës kërkimore-shkencore Institut i Xehetarisë i Beogradit humbte tregun e punës dhe e dyta, sepse përmes hulumtimeve arrihej të mbahej kontrolli politik dhe dominimi mbi “Trepçën”. Problem më vete ishte kuadri shkencor, i cili në atë periudhë ishte deficitar dhe i nacionalitetit serb, kështu që largimi i tij nga Kosova dhe përqendrimi në Beograd stimulohej në forma të ndryshme. Nga pikëpamja organizative, në vitin 1980 Institut i Plumbit dhe i Zinkut përbëhej nga këto njësi: 1) Enti për Gjeologji-Xehetari; 2) Enti për Metalurgji dhe Teknologji Kimike; 3) Enti për Projekte Industriale; 4) Enti për Analiza Teknike dhe Ateste; 5) Enti për Punë Inxhinierike dhe 6) Enti për Ekonominë Industriale dhe Marketing. Në këto vite Institut i kishte 35 hulumtues shkencorë, që merreshin me punë zhvillimore. Ky numër ishte shumë më i vogël dhe nuk ishte në pajtim me nivelin e zhvillimit ekonomik të “Trepçës”, ndërsa numri i përgjithshëm i kuadrove të Institutit, të sistemuara në tituj shkencorë dhe profesionalë, ishte 125. Financimi i punës shkencore në Institut bëhej mbi parimet e ekonomisë së tregut, me kontrata dhe marrëveshje me repartet e kombinatit. Që nga viti 1968, Institut i botoi revistën shkencore “Plumbzinku”, që doli me ndërprerje. Përveç revistës, Institut i kishte edhe botimet e veta të veçanta. Ky Institut ndodhet në pjesën veriore të Kosovës dhe nuk është më në funksion. (Minir Dushi)

INSTITUTI I PYLLTARISË, PEJË. U themelua në vitin 1948, si stacion eksperimental në kuadër të Institutit për Pylltari të Beogradit. Gjatë historisë së tij Instituti pati shumë transformime. Nga viti 1955 vepron si institucion i pavarur i Kosovës. Aktualisht është në përbërje të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural me emrin Agjencia e Pylltarisë e Kosovës. Instituti i pylltarisë merret me punë shkencore-hulumtuese, me projektme dhe me aplikimin e shkencës në praktikën pyjore të Kosovës. Lëmi i hulumtimeve përfshin: silvikulturën në pyjet natyrore, meliorimin e pyjeve të degraduara dhe të devastuara me kulturat pyjore, tipologjinë e pyjeve, mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit dhe patogjenët, mbarështimin e pyjeve, eksploatimin e pyjeve dhe gjuetinë. Në kuadër të Institutit është edhe prodhimtaria e fidanëve pyjorë. Në vitet e fundit Instituti ka organizuar edhe sektorin për arkitekturën e peizazhit dhe prodhimtarinë e bimëve dekoruese. Në periudhën 1971-1975 ka bërë inventarizimin e dëmtuesve dhe patogjenëve pyjorë, sipas lokaliteteve. Institut ka të pajisur mirë laboratorin për hulumtime shkencore. (Ibrahim Muja)

INSTITUTI I SHKENCAVE SOCIALE DHE HUMANISTIKE (ISHSH). Është institucion i lartë shkencor, i cili ka për synim fuqizimin e aspektit hulumtues në fushën e shkencave sociale dhe humanistike përmes implementimit të projekteve dhe përdorimit të metodave bashkëkohore hulumtuese. U themelua në vitin 2011, si njësi e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Veprimtaria shkencore e ISHSH-së përfshin projekte hulumtuese nga fusha e shkencave sociale dhe humanistike, pastaj organizimin e debateve përmes tryezave të rrumbullakëta, seminareve dhe konferencave shkencore, si dhe publikimin e librave dhe revistave nga kjo fushë. Që kur është themeluar, ISHSH-ja ka botuar tre numra të revistës shkencore “Njohja”, me seritë e shkrimeve nga fusha e filozofisë, sociologjisë, psikologjisë dhe shkencave politike. Në kuadër të ISHSH-së funksionon edhe Qendra për Hulumtime dhe Studime Gjinore në UP. Që nga themelimi i tij, ISHSH-ja ka realizuar disa projekte, prej të cilave do veçuar projekti për përfshirjen e arsimimit për të drejtat e njeriut në arsimin e lartë, pastaj projekti për fuqizimin e hulumtimit social shkencor në Kosovë dhe

integrimi në asociacionin europian të hulumtimeve të kësaj fushe etj. (Agon Sinanaj)

INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS (IKSHPK). Institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës në fushën e shëndetit



INSTITUTI I SHËNDETËSISË PUBLIKE NË PRISHTINË

publik, që ka për detyrë përgatitjen dhe vënien në jetë të strategjisë për shëndetin publik, zhvillimin e veprimtarive hulumtuese, kërkimore-shkencore dhe formimin profesional të punëtorëve shëndetësorë të Kosovës. Në vitin 1925 në Pejë u themelua shërbimi i parë higjienik-epidemiologjik, me ndihmën e fondit “Rockfeler” nga SHBA-ja. Që atëherë janë vënë bazat e mjekësisë preventive në Kosovë. Gjatë viteve 1923/24 në Prizren ishte themeluar shërbimi bakteriologjik tejet efikas për kohën, që ofronte shërbime për tërë territorin e Kosovës. Në vitin 1947 u themelua shërbimi higjienik-epidemiologjik dhe sanitar i Kosovës, ndërsa më 1951 u formua Enti Epidemiologjik i Kosovës. Në vitin 1966 u themelua Enti për Mbrojtjen Shëndetësore të Kosovës. Në vitin 1974 Kuvendi i Kosovës e riemëron këtë institucion si Enti Krahinor për Mbrojtjen Shëndetësore të Kosovës, me pesë ente rajonale në tërë territorin e Kosovës. Pas hapjes së Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1974, Enti bëhet bazë mësimore e Fakultetit dhe themelon Institutin e Epidemiologjisë, të Higjienës, të Mikrobiologjisë dhe të Mjekësisë Sociale. Në vitin 2000 ky institucion emërohet si Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Instituti sot shërben si bazë e rëndësishme mësimore për 5 degët e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës dhe ka pesë

departamente (epidemiologji, ekologji humane, mjekësi sociale, mikrobiologji dhe sistemin e informimit shëndetësor). IKSHPK-së në vitin 2005 i bashkohen institutet rajonale në Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjiilan, kurse për rajonin e Prishtinës luan edhe rolin e institutit rajonal. IKSHPK-ja shërben si referues i Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës për strategjinë dhe planifikimin shëndetësor, për ekonominë shëndetësore, për kontrollin e cilësisë së punës, për situatën epidemiologjike dhe për sëmundjet jorgjithëse, për menaxhimin e programit të zgjeruar të imunizimit (për furnizimin me vaksina dhe material sanitar), për mbikëqyrjen e infeksioneve brendaspitalore; për vlerësimin e gjendjes sanitare në objektet publike, shoqërore dhe private; për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, të ushqimit dhe të ushqyerjes së popullsisë; për shkallën e ndotjes së ajrit, përfshirë edhe mikrobiologjinë e mjedisit dhe atë klinike; për planifikimin familjar dhe kujdesin për nënën dhe fëmijën etj. IKSHPK-ja është qendër referuese e Kosovës për tuberkulozin, HIV/AIDS-in, zoonozat, gripin, sëmundjet kronike jorgjithëse etj. Në këtë Institut, bashkë me ato rajonale, punojnë 72 mjekë (specialistë, magjistra dhe doktorë të shkencave), 135 infermierë, 25 bashkëpunëtorë shëndetësorë etj. (Isuf Dedushaj)

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS (IPK). Institucion i lartë profesional-hulumtues në fushën e arsimit dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve parauniversitarë. U themelua më 2007, sipas një marrëveshjeje midis Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Qeverisë Italiane. Fillimisht u pranuan 24 hulumtues, të cilët u trajnuan në Institutin Rajonal të Arsimit (IRRE) në Milano të Italisë. Veprimtaria e IPK-së ndahet në katër sektorë: sektori i hulumtimeve, sektori i arsimit gjatë gjithë jetës, sektori i arsimit të përgjithshëm dhe sektori për vlerësim dhe standarde. Nga viti 2010 Instituti botoi revistën “Kërkime pedagogjike”. Ka botuar edhe dhjetë vepra profesionale-pedagogjike. (Ismet Potera)

INSTITUTI PËR HULUMTIME BIOLOGJIKE DHE MJEDISORE (IHBM). U themelua në vitin 2013 me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës. Është institucion hulumtues ndërdisiplinar në kuadër të Universitetit të Prishtinës, i cili

angazhohet që përmes hulumtimeve shkencore të promovojë kërkimet në shumë fusha të biologjisë: ekologji, ekotoksikologji, gjenetikë, fiziologji, biokimi, ekofiziologji, biodiversitet, menaxhim i mjedisit, fitokimi, etnobiologji, me qëllim të përmirësimit të mjedisit jetësor, rritjes së mirëqenies së popullatës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore në Kosovë në harmoni me progresin dhe zhvillimet ekonomike e sociale. (Behxhet Mustafa)

INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM (INKOS). Në vitin 1968 në kombinatin “Kosova” të Obiliqit u krijua qendra për kërkime, e cila më vonë (1975) u përparua në Ent për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim, kurse në zhvillimin e mëtejshëm u shndërrua në Institut për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim i Elektroekonomisë së Kosovës (INKOS). Në skemën organizative të INKOS-it kanë qenë këto njësi: 1) Enti i Xehetarisë; 2) Enti i Gjeologjisë; 3) Enti i Kimisë dhe i Kërkimeve Teknologjike; 4) Enti i Termoteknikës dhe i Defektoskopisë; 5) Enti i Projektiveve dhe i Konstruksioneve; 6) Enti për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor dhe 7) Enti për Informatikë dhe Kërkime Ekonomike. Në vitin 1982, INKOS-i kishte 210 të punësuar, nga të cilët katër doktorë shkencash dhe një magjistër. INKOS-i kreu studime dhe projekte të ecurive të proceseve të punës në mihje sipërfaqësore, kërkime gjeologjike e laboratorike dhe eksperimentime të qëndrueshmërisë së shkallëve të qymyrit e të shterpës të mihjeve sipërfaqësore (Mirash, Bardh dhe Sibofc), si dhe organizoi dhe drejtoi punën zhvillimore në kombinatin “Kosova”. Me gjithë avancimin e punës kërkimore-shkencore, INKOS-i nuk iu përgjigjej nevojave reale që kishte prodhimi në atë fazë të zhvillimit të elektroekonomisë, si njëra ndër degët më të rëndësishme ekonomike të Kosovës. Instituti INKOS botoi revistën “REMH-XEMK” (xehetaria, energjetika, metalurgjia, kimia), organizoi konferenca shkencore nga lëmi i xehetarisë dhe i energjetikës dhe nxori disa botime të veçanta nga kjo fushë. Ky institut u privatizua dhe vazhdoi të punojë si shoqatë aksionare. (Minir Dushi)

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE TË KULTURËS (IKMMK). U themelua në vitin 1954 nga Këshilli Krahinuer i Kosovës dhe Metohisë, si



INSTITUTI PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE TË KULTURËS

institucion për mbrojtjen dhe studimin shkencor të monumenteve të kulturës, që më pas u njoh me emrin Enti Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Nga viti 1999 mori emrin Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Ndonëse kaloi nëpër faza të ndryshme të organizimit, Instituti e ruajti vazhdimësinë e punës dhe të funksionit. Para vitit 1999, veprimtaria për mbrojtjen e monumenteve mbahej nën tryzni politike, për ta trajtuar me prioritet trashëgiminë serbe dhe monumentet e kulturës bizantine, situatë që kulmoi në vitet '90 të shekullit të kaluar. Aktualisht Instituti është i vendosur në një shtëpi tipike të shek. XIX, në afërsi të qendrës së vjetër të Prishtinës. IKMM-ja merret me evidentimin, inventarizimin, ruajtjen, mbrojtjen, valorizimin, vlerësimin kritik, studimin, konservim-restaurimin, publikimin dhe promovimin e trashëgimisë së paluajtshme në territorin e Kosovës. Institucioni në strukturën e tij ka sektorin e hulumtimit shkencor dhe dokumentacionin, sektorin e konservim-restaurimit të arkitekturës dhe sektorin e konservim-restaurimit të pikturës. Instituti ka në varësi gjashtë qendra rajonale të trashëgimisë kulturore: në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan. (Fejz Drançolli)

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR (IPH). Institucion shtetëror i Kosovës, i themeluar (2003) në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, me qëllim të plotësimit të kapaciteteve humane në fushën e planifikimit hapësinor. Është institucioni i vetëm shtetëror përgjegjës, i cili merret me koordinimin e proceseve të planifikimit hapësinor për nivelin qendror të

qeverisjes. Aktualisht është pjesë përbërëse e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe, së bashku me Departamentin e Planifikimit Hapësinor, përbëjnë sektorin e planifikimit hapësinor në Qeverinë e Kosovës. Deri më tash, nën koordinimin e IPH-së janë hartuar dhe aprovuar në Kuvendin e Kosovës disa dokumente të rëndësishme, si: Plani Hapësinor i Kosovës (2011), Plani Hapësinor “Fusha e Mihjes së Re” (2011), Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri” (2014), Plani Hapësinor “Ujëvarat e Mirushës” (2014), duke përfshirë edhe disa hulumtime, analiza dhe dokumente të tjera të kësaj fushe. (Luan Nushi)

INSTRUMENTET POPULLORE. Vegla muzikore tradicionale me përhapje të gjerë në popull dhe me disa dallime në vise të ndryshme të vendit. Për punimin e veglave muzikore në popull janë përdorur lëndë dhe mjete të ndryshme rrethore, si: gjethet e pemëve, fijet e barit dhe të kallamit, lëvorja e drurit dhe lëkura e kafshëve, puçla shpezësh, kocka etj. Punishtet e para për punimin e instrumenteve muzikore u hapën në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Sipas mënyrës së punimit, veglat muzikore ndahen në: idiofone (gurët, tokëza, çanga, rraketakja, gurrëza, lugët, masha, tepsia, këmborët, cungrana), membranofone (fyellzanim qypi, defi, tupani ose daullja), aerofone (ciqa ose picata, fuza, bredhkaqet, llullaku, gëzhoja, bilbili, pipi, fyelli, kavalli, zumarja, gajdet, surla, klarineta), kordofone (çiftelia, qytelia, bakllamaja, sharkia, buzuku, sazja, lahuta, violina ose qermania). Nga të gjitha këto vegla muzikore, në Kosovë përdoren më shumë çiftelia, sharkia, lahuta, surla, tupani, darabuku, defi, fyelli, kavalli, tepsia etj. Disa nga këto instrumente janë autoktone, të tjerët janë huazuar nga popuj dhe kultura të ndryshme. Instrumenti më i vjetër popullor, që njihet ndër shqiptarët del të jetë *gjethi* ose *fleta*. Zakonisht është përdorur gjethi i ahut, por edhe i arrës, i lajthisë, i mollës etj. Ndërkaq, njëri nga instrumentet muzikore me traditë më të gjatë ndër shqiptarët konsiderohet *lahuta*, me të cilën malësoret shoqëruan këngët mesjetare të ciklit të kreshnikëve. Çiftelia, ndërkaq, ka qenë dhe vazhdon të jetë instrumenti më i përhapur në Kosovë. Në popull quhet “çifteli”, “qiteli”, “qyteli” etj., varësisht nga treva ku gjendet. Përdoret kryesisht për shoqërimin e këngëve lirike dhe epike, si dhe

në formacione tradicionale, bashkë me veglat e tjera muzikore. Edhe *sharkia* në Kosovë zë vend të rëndësishëm midis veglave muzikore. Shumë studiues e cilësojnë si tambur me 4-5 tela, me origjinë nga shek. XVII. Vegla tjetër muzikore gjithashtu e përhapur në Kosovë është *fyelli*, i njohur si instrument i barinjve. Fyellit i bien kryesisht burrat. *Kavalli*, po ashtu instrument i vjetër, punohet nga druri ose alumini. *Surla* përdorej dhe vazhdon të përdoret nëpër dasma dhe ahengje të ndryshme, ndaras ose në shoqërim të tupanit. Secila nga këto vegla muzikore e ka pasur ambientin e vet etnografik: vatrën, kullën, kullotën në livadhe, stanin në bjeshkë etj. Zbukurimi i jashtëm me shenja e simbole të ndryshme zinte vend të rëndësishëm në prestigjin e veglave të veçanta muzikore tradicionale. (Angjelina Hamza)

INTEGRIMI EKONOMIK. Nënkupton reduktimin e barrierave në transaksionet ndërkombëtare ndërmjet shteteve, si dhe në lëvizjen e lirë të mallrave, të kapitalit, të faktorit njeri, përfshirë edhe harmonizimin e legjislacionit dhe të standardeve. Disa nga format tipike të integritit janë: marrëveshjet për tregti të lirë, unioni doganor, tregu unik, tregu i përbashkët, unioni ekonomik. Në teorinë ekonomike njihen dy lloje të integritit ekonomik: integrimi i tregut dhe integrimi i politikave ekonomike. Integrimi i tregut përfshin eliminimin e barrierave tregtare ndërmjet dy apo më shumë vendeve të caktuara, ndërsa integrimi i politikave ekonomike përfshin kooperimin dhe koordinimin e politikave. Kosova është përfshirë në integrimet rajonale dhe në ato të Bashkimit Europian (BE). Në Samitin e Selanikut të vitit 2003 është hapur procesi i integritit të Ballkanit Perëndimor në BE që përfshin marrëveshjet rajonale të tregtisë së lirë, respektivisht liberalizimin e tregut, transportin rajonal, bashkëpunimin ndërkufitar, luftimin e krimit të organizuar në nivel rajonal etj. Pavarësisht nga problemet politike, Kosova ka arritur të jetë pjesëmarrëse në të gjitha iniciativat e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore dhe njëkohësisht filloi negociatat bilaterale për tregti të lirë me Shqipërinë dhe Maqedoninë, bazuar në memorandumun e mirëkuptimit për liberalizimin e tregut në Europën Juglindore të vitit 2001. Më pastaj, meqë CEFTA si marrëveshje unike të tregtisë së lirë në Europën Qendrore e arritur në vitin

1992 kishte shërbyer si mekanizëm transitor dhe si parapërgatitje për integrim të këtyre vendeve në BE, modeli i njëjtë u shfrytëzua edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 1999 Bashkimi Europian kishte propozuar procesin e stabilizim-asocimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërsa në vitin 2002 propozoi mekanizmin përcjellës të stabilizim-asocimit për Kosovën, si një mekanizëm për plotësimin e kriterëve të kërkuara nga Bashkimi Europian për arritjen e reformave politike, ekonomike dhe institucionale. Në vitin 2015 Kosova nënshkroi edhe marrëveshjen e stabilizim-asocimit, e cila pritet të hyjë në fuqi më 2016 dhe që avancon statusin politik dhe institucional të Kosovës, por edhe atë ekonomik, duke i ofruar Kosovës qasje në tregun e Bashkimit Europian, në kuadër të një kornize të qëndrueshme dhe pako të reformave ligjore për të ndërtuar ekonomi konkurruese me rritje të qëndrueshme. (Gazmend Qorraj)

INTERNALIZIMI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE NË TË DREJTËN E KOSOVËS (1999-2008). Qasja juridike me të cilën dokumenteve bazike ndërkombëtare u jepej fuqi juridike si ligje të brendshme. Me hyrjen në fuqi të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë përcaktohen si norma juridike të zbatueshme në Kosovë edhe dokumentet bazike ndërkombëtare nga fusha e të drejtave dhe të lirive të njeriut, si: Deklarata universale për të drejtat e njeriut e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) e vitit 1948, dy pakot e OKB-së për të drejtat e njeriut (1966), Karta sociale, Konventa europiane për të drejtat e njeriut (1950) etj. Në këtë mënyrë, dokumentet bazike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u bënë dokumente juridike të zbatueshme në Kosovën e pasluftës, sikundër edhe ligji i brendshëm. Me këtë veprim ishte krijuar i ashtuquajtimi internalizim i së drejtës ndërkombëtare, apo përbrendësimi i së drejtës ndërkombëtare në sistemin juridik vendor, si normë e obligueshme juridike e vendit. Kjo qasje vazhdoi edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008). (Blerim Reka)

INTERVENIMI SHTETËROR (NDËRHYRJA SHTETËRORE). Ndërhyrja e shtetit në politikën aktive ekonomike, më shpesh në kushtet e krizës. U manifestua sidomos në krizën e madhe të vitit 1929-33, pasi kjo nuk

arriti të bëhej me të ashtuquajturën iniciativë të kapitalit privat. Ky koncept lidhet me emrin e J.M.Kejnsit, i cili, i vetëdijshëm për faktin se kapitalizmi në fazën e monopolizmit nuk mund të funksionojë nën veprimin stihik të ligjeve ekonomike dhe të liberalizmit, parashtrroi kërkesën për ndërhyrjen e shtetit në ekonomi. Si ideolog i kapitalizmit shtetëror, ai theksoi se shteti, përmes rishpërndarjes së të ardhurave kombëtare dhe me investime të drejtpërdrejta në ekonomi, duhet të krijojë parakushte për të penguar ngecjen dhe rënien e kapitalizmit. Shteti sot ndërhyr në ekonomi për të mbajtur në nivel të duhur veprimtarinë investive dhe të sigurojë vende të reja pune. Në Kosovë ndërhyrja e shtetit është më e theksuar nëpërmjet politikave fiskale dhe përkrahjes së qeverisë, që u bën me anë të subvencioneve sektorëve të caktuar të ekonomisë, si: energjetikës, minierave, bujqësisë, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin ekonomik të vendit. (Myrvete Badiviku)

INVENTARI. Ndryshe quhen edhe stoqet e aseteve të rëndësishme të një subjekti afarist. Sipas standardeve kosovare të kontabilitetit, stoqet janë pasuri që mbahen për t'u shitur gjatë rrjedhës së rëndomtë të afarizmit, që janë në procesin e prodhimit apo në formë të furnizimeve, të cilat do të konsumohen gjatë procesit të prodhimit ose të shërbimeve. Stoqet zakonisht përbëhen nga lënda e parë, gjysmëproduktet dhe produktet e gatshme të ndërmarrjet prodhuese, apo nga malli të ndërmarrjet tregtare. Gjendja, përkatësisht sasia e tyre konstatohet nëpërmjet një procesi të regjistrimit, që rëndom bëhet në fund të vitit. Për këto subjekte afariste inventari përfshin të gjitha mallrat në posedim dhe të mbajtura për shitje gjatë veprimtarisë së saj të rregullt operative. Si çdo aset tjetër afatshkurtër, i tillë është edhe inventari, sepse pritet që të shndërrohet në para në më pak se një vit. Sipas shkallës së likuiditetit, në bilancin e gjendjes renditet menjëherë pas llogarive të arkëtueshme. Në Kosovë stoqet (inventari) më të theksuara janë në ndërmarrjet dhe fermat bujqësore (Skender Ahmeti)

INVESTIMET E JASHTME. Investim i bërë nga një entitet i një vendi në një firmë të një vendi tjetër, me anë të të cilit investitori i jashtëm bëhet pronar i së paku 10% të aksioneve ose i

fuqisë votuese të kësaj firme. Ky prag i nivelit të fuqisë votuese konsiderohet si një lidhje strategjike afatgjate ndërmjet investitorit dhe të firmës dhe siguron një ndikim të investitorit të jashtëm në menaxhmentin e firmës. Kjo lidhje afatgjate i bën investimet e jashtme të drejtpërdrejta më stabile sesa investimet e tjera dhe më të prira që të shoqërohen me transferim të teknologjisë në formë të aseteve fikse dhe në formë të shkathtësive menaxheriale të firma ku investon. Është pikërisht ky fakt që i bën investimet e jashtme të konsiderohen të dobishme për vendin, madje më të dobishme se investimet vendore dhe investimet e tjera të huaja. Disa prej faktorëve përcaktues për tërheqjen e investimeve të jashtme janë: madhësia e tregut vendor dhe norma e rritjes së tij, qasja në tregjet e tjera (përfshirë koston e transportit dhe barrierat artificiale si tarifatat doganore etj.), burimet natyrore dhe kostoja e tyre, çmimi i fuqisë punëtore dhe cilësia e saj, cilësia e infrastrukturës, korniza ligjore, cilësia e qeverisjes, politikat qeveritare, ngjashmëritë kulturore, gjuhësore dhe të etikës biznesore me vendin prej nga vjen investitori i huaj etj.

Në periudhën e pasluftës në Kosovë, investimet e jashtme të drejtpërdrejta kanë pasur lëkundje, duke reflektuar pjesërisht privatizimin e firmave të mëdha, kështu që disa vite të fundit edhe kemi pasur një trend të rënies së tyre. Sektorët ekonomikë ku janë përqendruar investimet e jashtme janë patundshmëritë (që reflekton ndikimin e diasporës), shërbimet financiare, telekomunikimi, industria përpunuese dhe ndërtimtaria. Vendet kryesore prej nga kanë ardhur investimet e jashtme në Kosovë janë: Gjermania, Britania e Madhe, Turqia, Zvicra, Sllovenia dhe Austria. (Artanë Rizvanolli).

INVESTIMET. Blerje e produkteve, të cilat nuk konsumohen në periudhën e tanishme, por shfrytëzohen përkatësisht angazhohen në formë të aseteve reale e financiare për të krijuar të ardhura të reja apo pasuri të re. Pra, një heqje dorë nga konsumi, për hir të pritjeve për përfitime më të mëdha serike në të ardhmen. Në financa investimi është blerje e aseteve monetare, me idenë që vlera e tyre do të rritet dhe do të shiten me çmime më të larta. Investimet e përgjithshme (agregate) janë përbërës i rëndësishëm i prodhimit të brendshëm bruto dhe ndikojnë pozitivisht në rritjen e tij. Pra, sa më të larta të jenë investimet

e përgjithshme apo sa më shumë të rriten ato, aq më shumë do të rritet edhe prodhimi i brendshëm bruto. Investimet e përgjithshme zakonisht paraqiten si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto. Në Kosovë gjatë një dekade investimet e përgjithshme (private e publike) kanë qenë 20%-25% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB), më saktësisht në vitin 2014 ato ishin 18% të PBB-së. Sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve (dokument i rëndësishëm qeveritar) nuk parashihet ndonjë rritje e dukshme e investimeve në vitet në vijim dhe ky paraqet një nga problemet më të mëdha që ndikon në rritjen e pamjaftueshme ekonomike në Kosovë. (Alban Zogaj)

IPEN Teodor A. (Theodor A. Ippen) (1861-1935). Diplomati dhe albanolog austriak. Lindi në Sezemice, distrikti i Bohemisë, atë kohë në kuadër të Perandorisë Austro-Hungareze.



TEODOR A. IPEN

Më 1884 u diplomua në Akademinë Orientaliste të Vjenës. Po atë vit u emërua në konsullatën e Austro-Hungarisë në Shkodër dhe më 1887 mori postin e zëvendëskonsullit, të cilin e mbajti për disa muaj. Pas një karriere të suksesshme diplomatike në Plevle, Jeruzalem e Stamboll, më 1897 u rikthye në Shkodër dhe mbajti postin e titullarit të konsullatës austro-hungareze (1900-1904). Gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) shërbeu si këshilltar i ambasadorit austro-hungarez, kontit Mensdorf, duke dhënë ekspertizën e tij në çështjen e përcaktimit të kufijve të shtetit shqiptar. Pas Luftës së Parë Botërore ishte një nga funksionarët më të lartë të Ministrisë së Jashtme të Austrisë. Pas daljes në pension vazhdoi veprimtarinë e tij në kuadër të "Komisionit ndërkombëtar për Danubin" (1921-1930). Veprimtari e T. Ipenit, si albanolog ishte e gjithanshme. Dha ndihmesë për zhvillimin e arsimit shqip në komunitetin katolik të vilajetit të Shkodrës. Në zbatim të politikës austro-hungareze, interesat e tij ishin gjeografike-etnografike (plotësim i hartës së Shqipërisë me vende të panjohura, korrigjimi i një numri toponimesh, të shkruara gabim në hartat ushtarake austro-hungareze) dhe arkeologjike, numizmatike, arkitekturore, historike e religjioze. Prej udhë-

timeve dhe informacionit të pasur që mblodhi, Ipeni kreu një sërë studimesh. Midis tyre dallohen monografitë: "Novi Pazar dhe Kosova: Rashka e vjetër" (Novibazar und Kossovo: das alte Rascien) (1892), "Stare crkvene ruševine u Albaniji" (Rrënoja e kishave të vjetra në Shqipëri) (1898), "Shkodra dhe ultësira bregdetare e Shqipërisë së Veriut" (Skutari und die nordalbanische Küstenebene) (1907), "Malet e Shqipërisë Veriperëndimore" (Die Gebirge des nord-westlichen Albaniens) (1908). T. Ipeni ka botuar edhe artikuj të shumtë shkencorë mbi viset veriore shqiptare kryesisht në gjermanisht dhe serbokroatisht. Për kontributin e dhënë, me rastin e 20-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, u dekorua nga Mbreti Zog I me "Urdhrin e Skënderbeut". (Ledia Dushku)

IPESHKVIA E KOSOVËS. Institucioni kryesor i Kishës Katolike për besimtarët e rritit katolik në territorin e Kosovës, në varësi të Selisë së Shenjtë. U ngrit si një administratë



SELIA E IPESHKVISË SË KOSOVËS

apostolike në vitin 2000, me seli në Katedralen e Zojës Ndihmëtare në Prizren, dhe sot në Katedralen e "Lumes Nënë Terezës" në Prishtinë, pasi u nda nga Ipehkvia Shkup-Prizren, kurse Ipehkvia e Shkupit u kthye në emrin e saj të mëparshëm - Dioecesis Scopiensis. Trashëgimtare e Argjipehkvisë së dikurshme të Dardanisë e ngritur që në shek. IV, Ipehkvia e Kosovës gjatë historisë, në varësi të rrethanave, ka ndryshuar disa herë statusin e saj.

Më 1993, Selia Shenjtë, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, bëri një riorganizim kishtar në këto hapësira, duke emëruar për ipeshkëv rezidencial të Kosovës imzot Nikë Prelën, me rezidencë në Prizren, i cili ishte ipeshkvi i

parë i ipeshkvisë së ripërtërirë të Prizrenit. Në nëntor të vitit 1995, Selia Shenjtë për ipeshkëv të Komunitetit Katolik Shqiptar të Kosovës emëroi dom Mark Sopin, shugurimi i të cilit, për shkak të rrethanave të vështira në Kosovë, u bë në Romë më 1996. Ndryshim i statusit administrativ të Kishës Katolike Shqiptare në Kosovë ndodhi edhe pas luftës së fundit dhe pas instalimit të administratës ndërkombëtare në Kosovë. Ipeshkvia ka katër dekanate (Prizreni, Gjakova, Prishtina dhe Peja) dhe 24 famulli. Në 22 famulli shërbejnë meshtarët dioqezianë, ndërsa në 2 famulli shërbejnë rregulltarët (në Gjakovë françeskanët dhe në Prishtinë salezianët). Në këtë ipeshkvi shërbejnë 42 meshtarë dioqezianë, 5 françeskanë dhe 4 salezianë. Në kuadër të ipeshkvisë veprojnë edhe motrat e nderit. Së fundi rezidenca e ipeshkvisë është vendosur në kuadër të kompleksit kishtar të katedrales së të Lumes “Nënë Tereza” në Prishtinë. Në vitin 2011, Papa Benedikti XVI caktoi për herë të parë një delegat apostolik për Kosovë, nuncin aktual në Slloveni, Juliusz Janusz, me detyrë që të plotësojë në mënyrë adekuate nevojat baritore të besimtarëve katolikë. Ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji, zyrtarisht shërben në detyrën e administratorit të Administraturës Apostolike në Kosovë. (Gjon Berisha)

IPESHKVIA SHKUP-PRIZREN. Institucion kryesor kishtar i kishës katolike për besimtarët katolikë në territorin Kosovës, Maqedonisë dhe të Sanxhakut. E ngritur që në shek. IV, si Argjipeshkvia e Dardanisë, vazhdoi të ekzistojë edhe pas rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit dhe gjatë gjithë mesjetës. Gjatë viteve 1340-1656 do të funksionojë përmes titullarëve të saj, derisa më 1656 argjipeshkvia përkohësisht u ripërtëri me emrin Argjipeshkvia e Shkupit (Scopiensis), nën kryesimin e argjipeshkvit shqiptar Andrea Bogdani (1656-1677). Në kohën e Andrea Bogdanit bëhet bashkimi i Argjipeshkvisë së Ohrit dhe Ipeshkvisë së Shkupit, si dhe të Ipeshkvisë së Prizrenit dhe të Shkupit. Gjatë sundimit osman, argjipeshkvinjtë katolikë u detyruan të vepronin jashtë selisë së tyre dhe të mbanin titullin e administratorëve apostolikë (argjipeshkëv) nën juridiksion e drejtpërdrejtë të Selisë së Shenjtë. Kisha Shkup-Prizren deri më 1914 ishte argjipeshkvi, kur pas nënshkrimit të Konkordatit ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Mbretërisë Ser-

be më 1914, titulli i argjipeshkvisë i kaloi Argjipeshkvisë së Beogradit, kurse ajo e Shkup-Prizrenit mbetet ipeshkvi. Më 1924 Ipeshkvia Shkup-Prizren i bashkëngjitet Selisë metropolitane të Vërbosnjës (Sarajevë), si sufragan (përkohësisht). Argjipeshkëv i fundit i Argjipeshkvisë së Shkupit ishte imzot Lazër Mjeda, i cili më 1921 u shkarkua nga detyra e argjipeshkvit në Argjipeshkvinë Shkup-Prizrenit dhe u transferua në Shkodër. Në vend të tij, më 1924, Papa Piu XI emëroi Janez Gnidovecin. Prej vitit 1821 deri më 1934 rezidencë ipeshkvnore ishte Prizreni, e pastaj kaloi në Shkup. Selia e Shenjtë në vitin 1969 bëri sërish riorganizimin territorial-administrativ kishtar në këto treva: u ripërtëri Ipeshkvia e dikurshme e Prizrenit, kështu që e tërë ipeshkvia quhet me emrin e ri: Ipeshkvia Shkup-Prizren (Scopiensis-Prisrianensis), e cila përfshinte Maqedoninë, Kosovën dhe Sanxhakun. Për Komunitetin e Katolikëve Shqiptarë u emërua për ipeshkëv ndihmës “sedi datus” imzot Nikë Prela (1970), kurse për ipeshkëv të Ipeshkvisë Shkup-Prizren u emërua Joakim Herbut. Ipeshkvia ishte e ndarë në tri dekanate (Maqedoni, Kosovë dhe Dukagjin) me 22 famulli. Më 1993, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Selia e Shenjtë sërish bëri një riorganizim kishtar në këto treva, duke emëruar për ipeshkëv rezidencial të Kosovës imzot Nikë Prelën, me rezidencë në Prizren, ndërsa për vikar gjeneral dom Ndue Gjergjin. Në nëntor të vitit 1995 Selia e Shenjtë për ipeshkëv të Komunitetit Katolik Shqiptar të Kosovës emëroi dom Mark Sopin. Ndryshimi i statusit administrativ të Kishës Katolike Shqiptare në Kosovë ka ndodhur edhe pas luftës së fundit dhe pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë. Në vitin 2000 ipeshkvia Shkup-Prizren u nda përsëri: Ipeshkvia e Prizrenit u bë Administratura Apostolike e Prizrenit, nën varësinë e drejtpërdrejtë të Selisë së Shenjtë, me seli në katedralen e Zojës Ndihmëtare në Prizren dhe sot në katedralen e Lumes “Nënë Tereze” në Prishtinë, kurse Ipeshkvia e Shkupit u kthye në emrin e saj të mëparshëm (Dioecesis Scopiensis), nën varësinë e Argjipeshkvisë së Vërbosnjës. (Gjon Berisha)

IRIS ILLYRICA (Shpatorja). Është bimë shumëvjeçare e familjes Iridaceae, e cila rritet në lartësi deri në 40 cm. Theofrasti (shek III p.e.s.) shkruan se kjo bimë nga Iliria është bima mjekësore më e mirë dhe më së shumti dallohet



SHPATORJA

nga të tjerat. Edhe Discoridi, mjek dhe farmakolog grek, i jep shumë vend kësaj bime në veprën e tij “De materia medica”. Bima mjekësore Rhizoma Iridis është eksportuar nga Iliria në Romë dhe është shitur me çmim të lartë. Shërbente për mjekimin e sëmundjeve të mushkërive, dhembjeve në bark, sëmundjeve të gojës dhe mjekimin e plagëve. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Informimit për Bimë (IOPI) statusi i mbjelljes së bimës Iris Illyrica është ende i pazgjithur. Iris Illyrica shpesh trajtohet si nënloj i Iris Dalmatian (Iris pallida). Periudha e lulëzimit të Iris Illyrica janë muajt maj-qershor. Mbillet në vende që i ekspozohen diellit. Kjo bimë shumë rrallë prodhon fara. Zakonisht prodhon dhjetë fara që piqen në vjeshtë. Shtrirja gjeografike e pranisë së bimës Iris Illyrica i përgjigjet rajonin antik të Ilirisë, prej nga edhe e ka marrë emrin: Kosovë, Shqipëri, Dalmaci (Kroaci), Mal të Zi, Maqedoni, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, ku rritet në formë të egër. Së pari ilirët dhe më pas edhe romakët e kanë konsideruar bimë me veti mjekuese. Po ashtu është besuar se Iris Illyrica ka vetinë e provokimit të abortit. Në kohë të lashta pjesë të kësaj bime janë shfrytëzuar si dezodorant dhe për përfitim të parfumeve. (Isme Humolli)

IRZNIQI. Fshat në komunën e Deçanit, 7 km në lindje të qendrës komunale. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar dhe shtrihet në lartësi mbidetare 545 m. Sipas regjistrimit të fundit (2011) në Irzniq jetojnë 1,739 banorë. Ka sipërfaqe prej 5.1 km², nga e cila rreth 90% janë toka bujqësore, pastaj livadhe, kullosa dhe zonë e ndërtuar. Elemente identifikuese të fshatit janë kullat e vjetra, që paraqesin objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike. Popullsia merret kryesisht me kultivimin e grurit, misrit si dhe perimeve për nevoja familjare. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor etj. (Idriz Shala)

ISAKU Luljeta (1954-). Studiuuese e kritike arti, mësimdhënëse. Lindi në Tetovë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Në Universitetin e Prishtinës kreu studimet për gjuhë dhe

letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik, ndërsa mbrojti disertacionin në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë. Në periudhën 1985-1990 punoi në Televizionin e Prishtinës, në redaksinë e emisioneve dokumentare. Është autore e shumë shkrimeve kritike, eseve, studimeve për letërsi, dramaturgji dhe teatër. Është autore e librave: “Utopia estetike si vetëdije mitike dhe kujtesë estetike”, “Leksikon i arteve dramatike” (bashkautore), “Refleksione I –II”. Është autore e dy dokumentarëve televizivë: “Edhe kështu jetohet” dhe “Të lutem frymo ndryshe”, të cilët fituan çmime në festivale të filmit dokumentar në ish-Jugosllavi. Është mësimdhënëse në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tetovës. (Salajdin Salihu)

ISAKU Murat (1928-2005). Shkrimtar, publicist. Lindi në fshatin Gajre të Tetovës. Kreu shkollën fillore në vendlindje. Vazhdoi shkollimin në Normalen e Elbasanit, pastaj në Prishtinë dhe Prizren, kurse maturoi në shkollën Normale të Gjakovës. Në Beograd kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, kurse më pas edhe Fakultetin Filozofik, degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe (1953). Punoi si arsimtar në Gjilan në vitin 1948,



MURAT ISAKU

mësimdhënës në gjimnazin e Tetovës, gazetar dhe redaktor në Televizionin e Shkupit, në programin e gjuhës shqipe. Krijimet e para letrare i botoi në vitet '60 në revistën “Jeta e re”, kurse përmbledhjen e parë poetike “Zani i malit” ia botoi “Rilindja” e Prishtinës më 1961. Ka botuar një sërë librash me poezi, me tregime dhe mbi dhjetë romane në Shkup, në Prishtinë, në Tiranë dhe në Tetovë. Përmbledhjet poetike: “Zani i malit” (1961), “Buzëqeshjet e mesditës” (1963), “Kurora e trollit” (1963) “Drithma” (1975), “Blana” (1982), “Ngushëllimi i bukur” (1989), “Shtara” (1994), “Egjër” (1998), “Dolli për gjërat e humbura” (2000), “Mëkatet e falura” (2008) etj. Është autor i romaneve: “Dielli e din rrugën e vet” (1965), “Gjaku i sharrëxhinjve” (1966/67), “Flaka e vonuar” (1973), “Plagët” (1975), “Rreckajt” (1979), “Etje” (1982), “Damkat” (1986), “Shtjella” (1989), “Rrengu” (1991) “Fatprerët” (1995) dhe “Banesa në katin e shtatë” (2001). Ka botuar tri përmbledhje me tregime: “Unaza e djerrinës” (1971),

“Gërsheta” (1978) dhe “Sheshtina” (1982). M. Isaku e nisi krijimtarinë letrare si poet dhe e përmbylli opusin letrar po me poezi. Kritika letrare e ka vlerësuar për talentin dhe shpirtin e veçantë poetik. (Salajdin Salihu)

ISEINI Mirsad (1980-). Aktor. Lindi në Çe-gran të Gostivarit, ku kreu shkollën fillore, kurse të mesmen në Gostivar. U diplomua për aktrim në Universitetin Shtetëror të Tetovës. U shqua për rolet në shfaqjet: “Stjuardesat” të M. Camolet, “Rreze dielli” të A. Popeskut, si dhe në filmat “Eshtrat” (2006) të M. Mançevskit, “Letra babait” të R. Bogdanovskit dhe “Panku nuk është i vetëm” (2009) të V. Blazevskit. Është fitues i disa çmimeve në festivale të ndryshme teatrore. (Salajdin Salihu)

ISLAMAJ Aziz (1952). Skulptor. Lindi në Murgë të Skënderajt. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1980). Punoi si arsimtar dhe kustos i muzeut në Skënderaj. Ishte drejtor për kulturë në komunën e Drenasit dhe mësimdhënës i artit në gjimnazin “Skënderbeu” po në Drenas. Merret me skulpturë nga viti 1975, kryesisht me materiale guri e druri. Preokupimet dhe motivet e tij mbështeten tek autoktonia dhe historia kombëtare si dhe te plasticiteti modern skulptural, deri te fryma e abstraksionit. Pesë nga veprat e tij janë në fondin e Galerisë Kombëtare në Prishtinë. Ka hapur disa ekspozita personale dhe ka qenë pjesëmarrës i një sërë ekspozitash kolektive. Është fitues i çmimeve dhe mirënjohjeve nga fusha e artit skulptural. (Agim Rudi)

ISLAMAJ Shefkije (1953-). Gjuhëtare, shkrimtare, albanologe. Lindi në Likoc të Skënderajt. Studimet për gjuhë dhe letërsi i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku më pas kreu edhe



SHEFKIJE ISLAMAJ

studimet pasuniversitare. Më 1999 mbrojti temën e disertacionit të doktoratës mbi veçoritë leksikore dhe stilistike të gjuhës në veprën e Jakov Xoxës. Që nga viti 1977 punon në Institutin Albanologjik të Prishtinës, tani me titullin këshilltare shkencore. Në Institutin Albanologjik ka udhëhequr degën e

gjuhës. Nga viti 2006 është kryeredaktore e revistës shkencore “Gjurmime albanologjike”, seria filologjike. Është anëtare e asociacioneve të gjuhëtarëve dhe të shkrimtarëve të Kosovës dhe anëtare e Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe. Botoi artikuj e studime të shumta. Është autore e veprave gjuhësore dhe letrare, e monografive studimore: “Çështje të sinonimeve në gjuhën shqipe” (1985), “Fjalor i fjalëve të huaja” (bashkautore, 1987), “Gjuha e Jakov Xoxës” (2000), “Kultura gjuhësore dhe përdorimi estetik i gjuhës” (2002), “Gjuha, ligjërimi dhe fjala” (2008), “Gjergj Fishta - gjuha dhe stili, I, II” (2012) etj. Është fituese e çmimit “Shkencëtar i vitit” nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2012). (Naim Berisha)

ISLAMI Abdylazis (1930-2005). Shkrimtar, përkthyes, gazetar. Lindi në fshatin Gajre të Tetovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Gjimnazin e ulët në Tetovë, kurse Shkollën



ABDYLAZIS ISLAMI

Normale dhe Akademinë Pedagogjike në Shkup. Punoi si mësues në Tetovë, më pas gazetar në Radio Shkupi, prej nga doli në pension. Me shkrime filloi të merrej si nxënës i shkollës së mesme, kurse poezinë e parë e botoi në vitin 1954. Është autor i shumë librave me poezi, tregime, romane, drama dhe studime. Poezitë e tij janë përfshirë në shumë panorama e antologji letrare dhe janë përkthyer në gjuhë të ndryshme. Motivët kryesorë të krijimtarisë së tij letrare vijnë nga vendlindja dhe njerëzit e saj, përfshirë të gjitha vështirësitë ekzistenciale që i shoqërojnë ata. Disa nga veprat e tij më të rëndësishme janë: “Këngët e zgjuara” (1968), “Era dhe vargjet” (1964), “Mëngjesi në fshat” (1965), “Soditje nga toka” (1969), “Barka ndër valë” (1971), “Kujtime dhe ëndrra” (1972), “Oaza” (1973), “Gurgurina” (1974), “Fatiana” (1975), “Ujërat” (1976), “Agullina” (1978), “Për qepallat e qiellit varen plepat” (1983), “Meleroti” (1986), “Krimi në tempull” (1987), “Yjet e vendlindjes” (1987), “Romancat e një nate vere” (1987), “Ëndrrat bulojnë në Eldorado” (1990), “Pëshpëritjet e udhëtarit plak” (1995), “Tatuazhe” (1996), “Feniksi” (2001), “Ninëza në koshadhe” (2002), “Përtej kohës” (2005) etj. Është autor i dramave për fëmijë: “Agimesha e ngujuar në shtatë

shpella”, “Kuvendi i guximtarëve” dhe “Arianda” (1994). Ka përkthyer disa libra nga gjuhët sllave në atë shqipe. Për krijimtarinë e tij kanë shkruar shumë studiues dhe kritikë letrarë. (Salajdin Salihu)

ISLAMI Agim (1947-). Mjek, stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, kurse Fakultetin e Stomatologjisë në Zagreb



AGIM ISLAMI

(1972). Pas diplomimit punoi si stomatolog në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Vijoi studimet universitare në Zagreb, ndërsa specializimin e kreu në Beograd, në Akademinë Ushtarake (1978). Më 1980 u zgjodh asistent i lëndës protetike stomatologjike në degën e stomatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Më 1990 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë mbrojti temën e doktoratës. Për shumë vjet ka qenë shef i lëndës dhe i klinikës së protetikës stomatologjike, si dhe shef i katedrës së stomatologjisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë. Ka bërë specializim në Universitetin Mbretëror të Londrës dhe është anëtar i Shoqatës Europiane të Protetikës. Është autor i librit “Fjalori terminologjik i protetikës stomatologjike anglisht-shqip” dhe përkthyes i dy teksteve universitare. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore-profesionale si autor dhe bashkautor. (Fatmit Dragidella)

ISLAMI Ard (1983-). Aktor, skenarist. Lindi në Gjilan, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2005). Më pas u mor me muzikë, veçmas me muzikën për teatër. Ka interpretuar disa role në disa shfaqje, si në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqjet: “Nata e dymbëdhjetë”, “Shtëpia në ankand”, “Dosja H”; pastaj në Teatrin “Oda”, ka luajtur në shfaqjet “Dhoma 13”, “Mbrëmje poetike Oda”, “Tre gjermanët e trashë”, “Lufta iliro-romake”; si dhe në Teatrin e Gjilanit: “Kumbara”, “Sakati nga Inishmani”, “UN Inspektori”, “Mon Liku”. Ndërsa në Teatrin “Dodona” ka luajtur në komedinë “Kush vjedh një këmbë, ka fat në dashuri”. Është autor i skenarëve për disa

filma të shkurtër dhe i skenarëve për serialet televizive “Spitaliks”, “Ëndrrat”, “O sa mirë”. Ka shkruar dhe dy tekste për shfaqje: “Dhoma 13” dhe “Vampirja”. Në fushën e muzikës dhe kompozimit ka realizuar disa projekte. Ka komponuar muzikën për disa shfaqje teatrore, si: “Smund të paguajmë”, “Koloneli Zog”, “Vigjili” etj. (Emin Emini)

ISLAMI Bedri (1954). Këngëtar. Lindi në Pejë. Pas shkollës fillore dhe të mesme në vendlindje, mbaroi Shkollën e Lartë të Turizmit në Dubrovnik. Kreu Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1976 punoi në Prishtinë në lëmin e turizmit. Me muzikë filloi të merret nga viti 1972, kur realizoi incizimin e parë në Radio-Prishtinë. Deri më 1987 ishte aktiv në muzikën e lehtë kosovare dhe përfaqësoi vlerat e saj në Kosovë e jashtë, duke fituar disa çmime. Mori pjesë në “Akordet e Kosovës” dhe në manifestime të tjera muzikore. Më 1981, si këngëtar i votuar, mori “Mikrofonin e artë” të Radio Prishtinës. Më 1997 iu rikthye “Akordeve të Kosovës” dhe me këngën “Sorkadhja” fitoi çmimin e parë. Ka marrë pjesë në festivale të ndryshme në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe në Festivalin e Radiotelevizionit Shqiptar. (Xhevdet Gashi)

ISLAMI Driton (1975-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Talinoc të Jerlive të komunës së Ferizajt. Kontaktet e para me UÇK-në i vendosi në Gjermani (1997). Në qershor të vitit 1998 u inkuadrua drejtpërdrejt në luftë, së pari në Malishevë dhe më pas në bazën e UÇK-së në Mrasor të Klinës. Kaloi kufirin Kosovë-Shqipëri rreth 25 herë, për furnizim me armatim. Në tetor të vitit 1998 u plagos në Gilloboçicë të Kaçanikut, ndërsa u shërua në Tetovë. Në fund të tetorit të vitit 1998 iu bashkua njësiteve të luftës në bazën e UÇK-së në fshatin Mollopolc të Shtimes, për të kaluar më pas në Zonën Operative të Nerodimes. Luftoi në Brigadën 161, në njësitin special për ndërhyrje të shpejta. Ishte pjesëmarrës në betejat që u zhvilluan në Mrasor, Kleçkë, Blacë, Budakovë, Reçak (beteja për kufomat) etj. Ra dëshmor më 18 prill 1999, në betejën e Slivovës të Ferizajt. (Skënder Lutfiu)

ISLAMI Hilmi (1952-). Mjek, farmakolog, profesor universiteti. Lindi në Podujevë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje,

ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1977). Një vit pas diplomimit u zgjodh asistent në Institutin e Farmakologjisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit. Më 1981 u emërua drejtor i Institutit të Farmakologjisë dhe ligjërues i lëndës së farmakologjisë me toksikologji në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Tezën e doktoratës nga lëmi i farmakologjisë klinike e mbrojti po në Prishtinë, (1983). Më pas u zgjodh docent, pastaj profesor inordinar dhe më 1994 profesor ordinar i lëndës farmakologji me toksikologji. Ka bërë specializimin nga farmakologjia klinike dhe mjekësia interne (1997), ndërsa për përsosje profesionale nga sistemi kardiorespirator më parë kishte qëndruar në Londër. Si bashkautor ka botuar disa tekste universitare: "Receptura mjekësore" (1985), "Farmakologjia mjekësore" (1988), "Bazat e farmakoterapisë" (2000). Ka marrë pjesë në kongrese dhe simpoziume, ka botuar shumë punime shkencore si autor dhe bashkautor. Ka botuar edhe disa broshura profesionale-farmaceutike. (Halil Ahmetaj)

ISLAMI Hivzi (1946-). Demograf, profesor universiteti, akademik. Lindi në vitin 1946 në Letovicë, Lugina e Preshevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në



HIVZI ISLAMI

Preshevë. Diplomoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, dega e gjeografisë (1970). Gjatë studimeve drejtonte revistën shkencore të studentëve "Dituria". Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit (1973), ndërsa doktoroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Lubjanës (1977). Për shumë vjet ligjëroi lëndën e demografisë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës (UP). Mbahti mësim edhe në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin Filozofik të UP-së. Në cilësi të profesorit të ftuar qëndroi në disa universitete të Francës, ku mbahti ligjërata nga demografia dhe për çështjen e Kosovës e të Ballkanit. Në vitin 1996 u pranua anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ku ushtroi funksionet më të larta të saj: sekretar shkencor, nënkryetar dhe kryetar në dy mandate (2011-

2017). E ka përfaqësuar ASHAK-un në takimet me akademitë simotra në rajon dhe në Europë, si dhe në asociacionet e tjera shkencore. Ka botuar një sërë librash shkencorë, ndër të cilët veçohen: "Popullsia e Kosovës (Studim demografik)" (1980 dhe 1981), "Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjiko-demografik të evolucionit rural të Kosovës)" (1985), "Kosova dhe shqiptarët (Çështje demografike)" (1990); libri "Realiteti demografik i Kosovës" u botua anglisht, gjermanisht dhe italisht; pastaj veprat "Rrjedha demografike shqiptare" (1994), "Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës" (1997), "Evolucioni dhe transicioni demografik" (1999), "Spastrimet etnike" (2003), "Lindshmëria - sjellja riprodhuese dhe shoqëria" (bashkautor) (2006); "Studime demografike (100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës)" (2005 dhe 2008), "Aspekti etnik i migrimeve (Shqiptarët në rrjedhat e shpërnguljeve të dhunshme)" (2012), "Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Luginën e Preshevës" (në bashkautorësi) (2015) etj. Botoi gjithashtu një numër studimesh, artikuj dhe trajtesa në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Botimet e tij janë kryesisht nga fusha e demografisë, në veçanti kapin çështjet demografike të Kosovës dhe të shqiptarëve. Në vitet '90 ishte aktiv në lëvizjen politike. Ishte themelues dhe kryetar i Partisë Fshatare, deputet dhe anëtar i delegacioneve të Kosovës në takime dhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare. (Arsim Ejupi)

ISLAMI Ilirjana (1970-). Juriste, profesore universiteti. Diplomoi për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1994). Studimet pasuniversitare për marrëdhënie




ILIRJANA ISLAMI

ndërkombëtare i mbaroi në Universitetin e Bilkentit në Ankara të Turqisë, ndërsa doktoroi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, si pjesë e një projekti bashkëpunimi me Fakultetin Juridik të Universitetit të Gracit në Austri (2007). U zgjodh asistente në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (1996) dhe më pas profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare publike dhe e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut po në këtë fakultet. Në

vitin 2009 u zgjodh gjykatëse në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për një mandat trevjeçar. Para emërimit në Gjykatë Kushtetuese, nga viti 2000 deri më 2009, shërbeu si këshilltar e lartë ligjore në departamentin për Sundim të Ligjit dhe të Drejta të Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim të Europës (OSBE), Misioni në Kosovë. Ka botuar disa punime shkencore dhe profesionale në revista të ndryshme ndërkombëtare. (Qerim Qerimi)

ISLAMI Myderriz Tefik (1917-2006). Titullar i fesë islame, publicist, mësimsdhënës universitar. Lindi në Gjakovë, mësimit e para fetare dhe medresenë i përfundoi në vendlindje, kurse studimet universitare në lëmin e drejtësisë islame i mbaroi në Kajro, në Universitetin “El-Ez’herit” (1948). Nga viti 1951 ishte mësimsdhënës po në këtë universitet, më pas ishte pedagog universitar në Algjeri (1967-1969), në Somali (1969-1972) dhe në Arabinë Saudite (1975-1978). Gjatë viteve 1978-1982 ishte këshilltar i ministrit të Vakëfeve të Egjiptit. Në botën arabe botoi një sërë shkrimesh për gjendjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Ishte aktiv me shkrime edhe në fushën profesionale. Për shkak të qëndrimeve politike, e kishte të ndaluar nga pushteti jugosllav vizitën në vendlindje. Vdiq në Kajro. (Nuridin Ahmeti)

ISLAMI Nebi (1943-). Dramaturg, kritik, përkthyes, mësimsdhënës universiteti. Lindi në Norçë të Preshevës, ku mbaroi shkollën fillore. Shkollën Normale e kreu në Prishtinë, ndërsa



NEBI ISLAMI

Akademisë Pedagogjike në Shkup. Studimet pas-universitare i përfundoi në Universitetin e Prishtinës (UP), ku mbrojtiti edhe tezën e disertacionit të doktoratës (1993). Botoi ese, recensione, artikuj kritikë dhe shkrime studimore për dramaturgjinë, teatrin, si dhe drama e komedi që janë inskenuar në teatrot e Prishtinës, Shkupit, Pejës dhe Gjilanit. Botoi dramat: “Hijesina” (2001), “Ligatina” (2006) dhe komeditë: “Të lumtë ne për këtë liri” (2000) dhe “Sfida e madhe” (2004). Me dramën “Hijesina” u shpërblye në konkursin e dramës shqipe në Tiranë (2003). Është autor i librit monografik “Histo-

ria dhe poetika e dramës shqiptare 1886-1996, I, II” (2003). Përktheu në gjuhën shqipe nga polonishtja poemën e Adam Mickijeviçit “Ëndërr dimri” (1976), si dhe veprën teologjike të Elen Vajtit “Beteja e madhe”. Ishte dekan i Fakultetit të Arteve të UP-së dhe njëri nga themeluesit e degës së dramaturgjisë në këtë fakultet, ku ishte ligjërues shumëvjeçar i lëndëve dramaturgjie dhe historia e dramës dhe e teatrit. Po ashtu ligjëroi në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Arteve të Bukura në Tiranë. (Arian Krasniqi)

ISLAMI Nehat (1943-). Gazetar. Lindi në Ferizaj. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, ndërsa Fakultetin Juridik në Universitetin e Zagrebit. Më 1966 nisi të punojë



NEHAT ISLAMI

në gazetën “Rilindja”, kurse më 1968 kaloi në redaksinë e emisionit televiziv “Shkëndija”, që transmetohej në gjuhën shqipe nga TV Beogradi. Në këtë redaksi përgatiti rreth 200 emisione dokumentare nga Kosova dhe hapësira shqiptare. Më 1973 nga gazeta “Rilindja” u caktua korrespondent i përhershëm në Lindjen e Mesme, me seli në Bejrut, ku qëndroi deri më 1979. Nga Bejruti u kthye redaktor i politikës së jashtme në redaksinë e “Rilindjes” dhe më pas u zgjodh sekretar krahinor për Informata. Pas ngjarjeve të vitit 1981 u shkarkua dhe më 1982 sërish u kthye në “Rilindje”, në redaksinë e politikës së jashtme. Me mbylljen e “Rilindjes” më 1990 vazhdoi punën në gazetën “Bujku”, deri më 24 mars 1999. Pas çlirimit të Kosovës, tri vjet udhëhoqi redaksinë e Kosovës të Institutit për Raportim të Luftës dhe të Paqes (IVPR), ku shkroi shumë artikuj për Kosovën në rrjetin botëror të IVPR-së. Në vitin 2005 u zgjodh drejtor ekzekutiv i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës. Është autor i shumë fejtoneve dhe reportazheve nga Kosova dhe bota. Botoi librat “Hotel Bejruti” (2013) dhe “Një adresë në Bukuresht” (2016). (Shefqet Rexhepi)

ISMAILI Hilmi (1943-). Jurist, profesor universitar. Lindi në Koliq, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore, gjimnazin dhe Fakultetin Juridik i kreu në Universitetin e Prishtinës, studimet pasuniversitare i vijoi në Universitetin



HILMI ISMAILI

e Beogradit, ku mbrojti edhe tezën e doktoratës (1979). Pas diplomimit u zgjodh asistent për lëndën historia e shtetit dhe e së drejtës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Më pas, po në këtë fakultet, u gradua në të gjithë titujt universitarë. Përveç historisë së shtetit dhe të së drejtës, ligjëroi edhe të drejtën zakonore, ndërsa në Fakultetin Filozofik ligjëroi lëndën etnologjia juridike. Në procesin mësimor ka qenë i angazhuar edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë atë të dekanit të Fakultetit Juridik, kryeredaktorit të revistës “E drejta” etj. Botoi monografinë “Burime të zgjedhura historiko-juridike” (2001) ndërsa është bashkautor i tekstit universitar “Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës” (2000). (Ejup Sahiti)

ISMAILI Imam Vehbi (1919-2008). Titullar i fesë islame, autor, përkthyes. Lindi në Shkodër, ku kreu shkollën fillore, kurse në Tiranë kreu Medresenë e lartë tetëvjeçare. Në vitin 1945 u diplomua në Universitetin “El-Ez’her” në Kajro. Për shkak të gjendjes politike në Shqipëri, mbeti në Egjipt. Më 1949, me ftesë të Shoqatës Shqiptaro-Amerikane, emigroi në Detroit, ku punoi si imam dhe mësues i gjuhës shqipe. Po këtë vit nisi botimin e revistës “Jeta muslimane shqiptare”, që botohej në shqip dhe anglisht. U angazhua për hapjen e xhamisë së parë shqiptare në SHBA (1951). Më 1993 u themelua Komuniteti Mysliman Shqiptar për SHBA dhe Kanada dhe kryetar u zgjodh imam Vehbiu. Ishte shembull i bashkëjetesës fetare ndër shqiptarët në Amerikë. Në periudhën 1970-1980 tri herë vizitoi Kosovën. Në vitin 1996 u dekorua nga presidenti i Shqipërisë me Urdhrin “Flamur i Demokracisë”. Shkroi dhjetëra vepra autoriale dhe përkthime nga gjuha arabe dhe angleze. Në vitin 2009, Shtëpia Botuese “Logos” e Shkupit e botoi në 28 vëllime veprën e tij. Vdiq në Detroit, SHBA. (Nexhat Ibrahim)

ISMAILI Jeton (1977-). Gazetar. Lindi në Vranjë. Shkollimin fillor e kreu në Tërrnoc,

të mesmin në Bujanoc, kurse studimet për gazetari i mbaroi në Prishtinë. Punoi si gazetar-korrespondent i gazetës “Koha ditore”, i Radios “Dutsche Welle” dhe i gazetës “Kosova sot”. Është themelues i radios “Toni” në Bujanoc (2001), mediumit të parë të pavarur elektronik në gjuhën shqipe në Serbi. Ka qenë edhe ligjërues në shkollën e gazetarisë në Bujanoc, bashkëthemelues i televizionit “Spektri” po në Bujanoc (2003). Është bashkëpunëtor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe autor i shumë teksteve në gazetata dhe në mediet elektronike të rajonit dhe më gjerë. (Zija Rexhepi)

ISMAILI Mersel (1929-). Mjek, internist, kardiolog, primarius. Lindi në Reçan të Gostivarit, shkollën fillore e kreu në vendlindje, semimaturën në Gostivar, kurse gjimnazin në Tetovë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1957). U emërua mjek i praktikës së përgjithshme në Qendrën Mjekësore në Gostivar. Prej vitit 1959 e ushtroi detyrën e drejtorit të spitalit, kurse më vonë edhe të Qendrës Mjekësore në Gostivar. Specializoi për mjekësi interne dhe studimet pasuniversitare nga kardiologjia i kreu në Beograd. U kthye në Gostivar dhe themeloi njësinë koronare. Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve profesionale-shkencore dhe pjesëmarrës në shumë simpoziume dhe kongrese. (Remzi Izairi)

ISMAILI Osman (1949-). Jurist, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse studioi për drejtësi në Fakultetin Ekonomik-Juridik të Prishtinës.



OSMAN ISMAILI

Në vitin 1974 u zgjodh asistent në Fakultetin Juridik për lëndën fillet e së drejtës. Po në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës magjistroi dhe më 1999 mbrojti tezën e doktoratës. Në vitet 1991-1996 ishte prodekan për mësim në Fakultetin Juridik dhe kontribuoi në organizimin e mësimit në kohën kur studentët dhe profesorët shqiptarë ishin dëbuar me dhunë nga objektet e tyre, nga pushteti i Serbisë. Ndërkohë, ligjëroi edhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës dhe në Universitetin

e Europës Juglindore po në Tetovë. Në cilësinë e profesorit të rregullt ligjëroi lëndët fillet e së drejtës, shkrimi dhe arsytimi ligjor, filozofia e së drejtës dhe metodologjia e së drejtës. Është autor i monografisë “Partitë politike shqiptare dhe çështja e Kosovës” (2001), i tekstit universitar “Fillet e së drejtës” (2004) dhe i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Ismet Salihu)

ISMAILI Rifat (1944-). Prozator, studiues i letërsisë. Lindi në Kopiliq të Epërm të Skënderajt. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Mitrovicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. U magjistrua dhe u doktorua në shkencat filologjike. Në fillim punoi si mësimdhënës në disa shkolla të mesme në Kosovë, ndërsa nga viti 1989 punoi si ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në periudhën 2002-2011 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Në fushën e letërsisë ka botuar vepra me ese dhe studime letrare: “Aspekte të prozës sonë” (1981), “Poetika e prozës së Jakov Xoxës” (1992), “Historia e letërsisë shqipe” (2003) etj. si dhe vepra nga fusha e prozës: “Kodra e varreve” (1988), “Hasan Prishtina” (1994), “Udhët e një jete” (2013). Në studimet e tij ka trajtuar çështje dhe fenomene që ndërlidhen me krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të ndryshëm të letërsisë shqipe, ndërkaq në tregimet dhe romanet e tij ka trajtuar tema dhe motive që kanë të bëjnë me personalitete kombëtare, por edhe tema të realitetit shqiptar. (Sali Bashota)

ISMAJLI Hatixhe (1966-). Pedagoge, mësimdhënëse universiteti. Lindi në Dibër, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, studimet në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1988), ku gjithashtu magjistroi (1996) dhe doktoroi (2007). Në vitin 1996 u angazhua mësimdhënëse në Universitetin e Tetovës, ndërsa prej vitit 2002 punon në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Është autore e disa punimeve shkencore-profesionale të botuara brenda dhe jashtë vendit. Në periudhën 2010-2014 ka marrë pjesë në disa projekte hulumtuese për edukimin qytetar të nxënësve të shkollës fillore. Botoi veprën “Teknologjia mësimore dhe të menduarit kritik” (2012). (Linda Salihu)

ISMAJLI Lorika (1982-). Soprano. Lindi në Gjilan. Mësimet e para muzikore i bëri për violinë në Shkollën e Ulët të Muzikës, pastaj për solokëndim në të mesmen. Pas dy vjetësh studimi në Fakultetin e Arteve të prof. Merita Juniku, i vazhdoi studimet dhe u diplomua në Konservatorin e Vjenës për solokëndim e repertor opere. Në vitet 2003-2005 ishte anëtare e Korit të Filarmonisë së Kosovës. Interpretoi rolet: Adina (“Lelisir d’amore”), Mimi (“La Boheme”), Liu (“Turandot”) dhe Lauretta (“Gianni Scchichi”). Shquhet për rolin e Konteshës nga opera “Le nozze di Figaro” të Mozart-it. Pati koncerte solistike në Prishtinë, Gjilan, Vjenë, Cyrih, Berlin, bashkëpunoi me dirigjentët R. Fontane, U-D. Soyka, J. Wildner, B. Llapaj, B. Çela, A. Dhomi. Relizoi masterkurse me G. Linos, V. Brunetti, E. Sunnegardh, J. Gjipali, I. Natchew, J. Pearson. Paraqitet në skenat vjeneze, sidomos me veprat e Mozart-it e Strauss-it. Vepron në Opera al Dente në Vjenë dhe soliste në “Sound of Austria”, Baumgarten palais. (Arnisa Rexhepi)

ISMAJLI Rexhep (1947-). Gjuhëtar, profesor, përkthyes, akademik. Lindi në Preshevë, ku përfundoi shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në



REXHEP ISMAJLI

Prishtinë (1971) dhe mbrojti disertacionin e doktoratës më 1982. Specializoi në Paris (1971-1973) te A. Martine dhe në Bohum (1977/78). Profesor i Universitetit të Prishtinës për gjuhësi të përgjithshme dhe histori të gjuhës shqipe. Më 1989 policia jugosllave e vendosi në “izolim” për 3 muaj në burgjet e Leskovcit, të Beogradit dhe të Prishtinës, pa mandat gjyqësor. Në vitet 1990-1994 mbajti mësim për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë shqiptare në Universitetin e Lubjanës. Më 1997 ishte profesor i ftuar, pastaj profesor për albanologji në Universitetin e Munihut, deri në vitin 2000. Në vitin 1993 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ndërsa më 1996 anëtar i rregullt, më pas kryetar në dy mandate (2002-2008). Nga viti 2002 anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave me seli në Salcburg, anëtar i jashtëm dhe anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në

periudhën 2008-2011 ishte kryetar i Këshillit Kombëtar të Shkencës të Kosovës. Njëri ndër themeluesit e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, sekretar dhe drejtor i tij. Nga viti 1991 u përfshi në lëvizjen politike në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ishte anëtar i kryesisë, i ngarkuar për marrëdhëniet ndërkombëtare. Më 1994 dha dorëheqje. Ishte sekretar i redaksisë së revistës "Studime" të ASHAK-ut nga viti 1994, kryeredaktor nga viti 2002. Bashkëthemelues dhe redaktor i botimeve "Fryma" (mbi 100 vëllime në fushën e dijeve shoqërore), "Rozafa" (letërsi), "Dukagjini Balkan Books" (frëngjisht, anglisht dhe gjermanisht), të shtëpisë botuese "Dukagjini". Është bashkëkryetar i Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe.

Kontributi i tij në fushën e albanistikës përfshin një spektër të gjerë studimesh filologjike, të historisë së gjuhës, të onomastikës, të semiotikës, të ballkanistikës, të gramatikës si dhe studimesh të tekstit dhe të sociolinguistikës. Nismëtar i studimeve funksionale të shqipes, të sociolinguistikës, të zgjerimit të gamës së hulumtimit përtej kufijve të fjalisë. Botoi librat "Shenjë e ide" (1974), "Shumësia e tekstit" (1977 dhe 1980), "Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit - studime mbi grafinë, fonetikën, fonologjinë" (1985), "Gramatika e parë e shqipes e vitit 1710" (1982), "Tekste të vjetra" (2000), ka shkruar studime për gjuhën e autorëve të vjetër, e botoi poezinë e Budit (1986). Në studimet sociolinguistike, pos "Gjuhë dhe etni" (1991), "Etni dhe modernitet" (1994), spikasin monografite: "Në gjuhë dhe për gjuhë" (1998) dhe "Standarde dhe identitete" (2003) dhe "Gjuhë standarde dhe histori identitetesh" (Tiranë, 2005). Më 2015 botoi monografinë për lidhjet e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane, e sidomos me ato të Ballkanit, "Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik" (2015). Është marrë edhe me studime letrare. Botoi një antologji të poezisë bashkëkohore arbëreshe (1978), të poezisë rumune (1979), të poezisë europiane (1990) dhe ka përkthyer autorë si M. Eminescu, A. Boske e Zh. Prever. Përktheu veprat teorike të F. Sosyrit, të A. Martinesë, të R. Bartit, "Fjalorin enciklopedik të shkencave të ligjërimit" nga Dykro dhe Todorov. Përkthimet e tij kanë sjellë një bazë të qëndrueshme të terminologjisë së gjuhësisë bashkëkohore në gjuhën shqipe. Përgatiti për botim veprat e albanologëve të huaj, ashtu si veprat e plota të

S. Rizës, I. Ajetit, F. Aganit etj. Ka organizuar konferenca të ndryshme për albanologjinë. (Bardh Rugova)

ISMAJLI Xhafer (1947-). Pedagog, mësimdhënës universiteti. Lindi në fshatin Kopiliq i Epërm, Skënderaj, ku kreu edhe shkollimin fillor. Arsimin e vazhdoi në Normalen e Mitrovicës, ndërsa studimet në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1974). Studimet e magjistraturës i filloi më 1975 në degën pedagogji-psikologji të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Sarajevës dhe i përfundoi në Universitetin e Prishtinës (2003), ku në vitin 2006 edhe doktoroi. Rreth 25 vjet kreu detyrën e pedagogut të shkollës në gjimnazin e Skënderajt. Në vitin 2006 u zgjodh mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës. U angazhua edhe në Universitetin e Mitrovicës. Është autor punimesh pedagogjike-psikologjike, ndër të cilat edhe i veprave "Në kërkim të njohjes dhe përballimit të stresit" (2006) dhe "Efektet stresuese të mësimdhënies dhe ecuritë e reduktimit të tyre" (2013). (Linda Salihu)

ISNIQI. Fshat në komunën e Deçanit, rreth 4 km në veri të qytetit. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar dhe shtrihet në lartësi mbidetare 590 m. Nëpër këtë vendbanim kalon rruga Pejë-Deçan-Gjakovë, ndërsa në pjesën jugore të fshatit rrjedh Bistrica e Deçanit. Sipas regjistrimit të fundit (2011) në Isniq jetojnë 3,861 banorë. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 69.4 km², nga e cila rreth 90% janë pyje, ndërsa pjesa tjetër me ara, livadhe dhe zonë e ndërtuar. Elemente identifikuese të fshatit janë kullat e vjetra, të cilat paraqesin objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike. Nga objektet e standardit shoqëror, fshati ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor etj. (Idriz Shala)

ISPAHIU Faik (1972-). Regjisor, producent. Lindi në Prishtinë. Studioi regjinë për televizion, film, radio dhe teatër. Që nga 2005 është regjisor dhe producent ekzekutiv i programeve të prodhuara nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe "Internews Kosova", siç janë "Jeta në Kosovë", "Drejtësia në Kosovë" etj. Është specializuar për trajnime në mediet elektronike, menaxhim, marketing dhe produksion televiziv. Gjithashtu udhëheq projektin e

monitorimeve të gjykatave të BIRN-it dhe realizon seritë e debateve televizive zgjedhore që prodhohen nga BIRN-i për Radiotelevizionin e Kosovës. Ka punuar për një sërë organizatash dhe projektsh në fushën transmetimeve televizive: ishte anëtar i ekipit themelues të kanalit televiziv “Kohavision”, ka themeluar dhe menaxhuar rrjetin e stacioneve ndëretnike radiofonike të pasluftës, CERPIK etj. Është drejtor ekzekutiv i “Internews Kosova”. (Ibrahim Berisha)

ISTOGU (BURIMI). Qytet në veriperëndim të Rrafshit të Dukagjinit. Shtrihet rrzë malit Mokna. Është zhvilluar në rrugën kryesore që lidh Pejën me Mitrovicën. Gjatë kohës së Per-



ISTOGU

andorisë Osmane, Istogu me rrethinë ka qenë njëra ndër katër kazatë e Sanxhakut të Pejës. Ndonëse shenjat e para të vendbanimit i hasim që në shek. XIV, deri në vitin 1924 ka pasur fizionominë e fshatit. Në këtë vit bëhet qendër e rrethit dhe falë funksionit administrativ shpallet qytezë. Hapat e parë të industrializimit filluan pas vitit 1947, me ndërtimin e hidrocentralit të parë me fuqi instaluese me 480 mijë kwh/vit. Sipërfaqet e mëdha me pyje kanë mundësuar zhvillimin e industrisë së drurit. Në këtë periudhë është ngritur edhe hurdha e peshqve, ku kultivohet trofta e Kalifornisë. Llojlojshmëria e funksioneve administrative, shkollore, shëndetësore, kulturore dhe tregtare e kanë shndërruar Istogun në qendër të rëndësishme të Podgurit të Pejës. Viteve të fundit në pjesën qendrore të qytetit dhe përgjatë rrugës së asfaltuar Istog-Gjyrakoc-Pejë janë ndërtuar shumë godina bashkëkohore. Istogu sipas shënimeve të vitit 1921, ka pasur 1,425 banorë, në vitin 1981 kishte 6,111 banorë, kurse në regjistrimin e fundit (2011) ka 5,115 banorë. Nga objektet

e standardit shoqëror dhe infrastrukturës publike ka dy shkolla të mesme (gjimnazin dhe shkollën e mesme profesionale), një shkollë fillore, shtëpinë e kulturës, bibliotekën e qytetit, muzeun arkeologjik, shoqërinë kulturore-artistike, palestrën sportive etj. Shërbimet shëndetësore qytetarët i realizojnë në qendrën kryesore të mjekësisë familjare. Pasuritë ujore, klima e përshtatshme dhe vlerat estetike të peizazhit ofrojnë mundësi për valorizimin kompleks të potencialit natyror. (Ferim Gashi)

ISTOGU (BURIMI) (komuna). Shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës me sipërfaqe 45,384 ha. Territori i saj përputhet me atë të rrethit të dikurshëm, qendra e të cilit ka qenë në Istog gjatë viteve 1912-1947. Në verilindje kufizohet me komunën e Mitrovicës, në lindje me komunën e Skënderajt, në jug me Klinën, kurse nga jugperëndimi dhe perëndimi me komunën e Pejës. Në veri ajo kufizohet me komunën e Rozhajës (Mali i Zi) dhe me komunën e Tutinit (Serbi). Territori i komunës së Istogut ka një rrjet mjaft të dendur hidrografik. Lumi i Istogut, i Vrellës dhe Drini i Bardhë kanë prurje të konsiderueshme ujore dhe u japin formë pasurive ujore të komunës. Bjeshkët e Istogut ofrojnë mundësi për valorizimin kompleks turistik atraktiv, ndërsa ujërat termominerale në lokalitetin e Banjës e kompletojnë ofertën turistike të komunës. Shpellat dhe monumentet e tjera të trashëgimisë natyrore paraqesin pikat atraktive turistike. Një pjesë e Parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna” përfshin edhe komunën e Istogut. Edhe mali Mokna me kushtet natyrore ofron mundësi për zhvillimin e turizmit malor. Tokat pjellore, kushtet e volitshme klimatike dhe burimet e shumta ujore paraqesin kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë. Kushtet më të volitshme për zhvillimin e bujqësisë janë në terrenet e lartësisë mbidetare deri në 500 m, ku ndodhen 14,160 ha, ose 31.2% e tokave bujqësore të komunës. Ndërsa në anën tjetër, peizazhet e bukura, trashëgimia e pasur natyrore dhe ujërat termominerale ofrojnë mundësi për valorizim turistik. Sektori më i zhvilluar i ekonomisë në komunën e Istogut është tregtia, e cila dominon strukturën e bizneseve sipas veprimtarive, edhe pse potenciali i kushteve dhe resurseve natyrore mundëson një valorizim kompleks në bujqësi, turizëm, industri etj. (Ferim Gashi)

ISTOGU Sabit (1951-). Gazetar. Lindi në fshatin Polluzhë të Skënderajt. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Skënderaj, kurse studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi në Skënderaj, ndërkaq nga viti 1981 ishte korrespondent i rregullt nga kjo komunë i gazetës “Rilindja” dhe bashkëpunëtor i Radiotelevizionit të Prishtinës. Gjatë viteve të luftës 1998/99 ishte reporter nga zona e Drenicës për gazetën “Rilindja”, Radiotelevizionin Shqiptar dhe Radion “Deutsche Welle”. Pas luftës punoi në gazetën “Rilindja”, dhe korrespondent në Radiotelevizionin e Kosovës. Botoi librin dokumentar “Rrënjët e lirisë” (2009), dramën “Të vrarë e të uritur” (2010) dhe skenarët për disa dokumentarë televizivë. (Behlul Jashari)

ISTREFI Adem (1942-). Shkrimtar. Lindi në Strellc të Epërm të Pejës. Me të mbaruar shkollën fillore, në moshën 14-vjeçare u arratis në Shqipëri. Pas shkollimit të mesëm, kreu studimet për gjuhë e letërsi në Universitetin e Tiranës. Një kohë të gjatë ka punuar në redaksinë e “Librit Shkollor” në Tiranë, më vonë redaktor në revistën “Nëntori”. Ka shkruar poezi dhe prozë, por është marrë edhe me kritikë dhe me publicistikë letrare. Ka botuar librat me poezi: “Net kosovare” (1967), “Mëngjesi i së nesërme” (1969), “Dritaret e fjalës” (1972), “Gjerdan lirie” (1977), “Një zog midis meje dhe diellit” (1989), “Arti i vdekjes bukur” (2007) etj; pastaj romanet: “Lëshoma hisen e diellit” (1984), “Lemeria” (1992), “Argatët e dreqit” (1997), “Kullukanxha” (2001), “Askundia” (2004); librat e tregimeve: “S`mund t`i lija pa folë” (1988) dhe “Nganjëherë i bëja me sy vdekjes” (2004). Jeton në Tiranë. (Shaip Beqiri)

ISTREFI Lutfi (1945-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Veleshtë të Strugës, Maqedoni. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaroi në vendlindje dhe në Strugë, më pas studioi për fizikë në degën përkatëse të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Zagrebit (1974). Tezën e disertacionit e punoi në Institutin e Fizikës së Zbatuar në Beograd dhe e mbrojti në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1981. Një kohë punoi mësimdhënës

i fizikës në Gjimnazin e Prishtinës. Në vitin 1971 zgjidhet asistent në FSHMN të UP-së, ku në vitet vijuese i mori të gjithë titujt universitarë. Ka qenë anëtar i komisionit për themelimin e Universitetit të Tetovës dhe njëri nga themeluesit e Unionit Ballkanik të Fizikës në Prishtinë (1985). Ka publikuar një numër punimesh dhe kumtesash shkencore, tekste për shkollën të mesme, tekstin universitar “Fizika e përgjithshme” dhe ka punuar në disa projekte shkencore. (Zahadin Shemsedini)

ISTREFI Nezir (1952-2004). Gazetar. Lindi në Strellc të Epërm të Deçanit. Pas shkollimit fillor dhe të mesëm në vendlindje, mbaroi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve, përkatësisht në studion e dramës të Shkollës së Lartë në Prishtinë. Një kohë punoi mësimdhënës në gjimnazin e Deçanit dhe më pas gazetar dhe redaktor në Radiotelevizionin e Prishtinës deri në mbylljen e tij nga Serbia në vitin 1990. Gjatë kësaj kohe ishte autor dhe producent i një sërë emisionesh dokumentare për ngjarje dhe personalitete të shquara kulturore dhe historike. Pas vitit 2000 punoi në Radiotelevizionin-21, si redaktor i programit dokumentar, ku realizoi ciklin prej 150 emisionesh dokumentare. Vdiq në një aksident trafiku. (Shaqir Foniqi)

ISTREFI Shkumbin (1969). Aktor, producent, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi edhe aktrimin në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP) (1994). Është aktor që ka krijuar një profil modern të aktrimit, sidomos në zhanër të tragjikomedisë. Realizoi dhjetëra role në teatër film dhe televizion. Veçohen rolet në shfaqjet teatrorë: “Kufiri me atdhe” në regji të autorit T. Dervishi,



SHKUMBIN ISTREFI

pastaj “Mbytma burrin”, “Jam talent se jo mahi” dhe “Iluzionet e dashurisë” në regji të F. Begollit, “Hamleti” në regji të D. Gothard, “Ëndrra e qenit” në regji të I. Qosjes, “Trëndafili tatuazh” në regji të F. Mehmetit, “Vdekja dhe Vasha” në regji të F. Berishës. Rolet e tij më të realizuara konsiderohen: Sladeku në “Audienca” në regji të Fatos Berishës (1997) dhe Vladimirit në “Duke pritur Godonë” në regji të F. Hysajt (çmimi special i jurisë për shfaqje në

Festivalin MESS të Sarajevës, 1997). Ndërsa nga rolet e tij të realizuara në film më i rëndësishmi konsiderohet Gafurri në filmin “Kukumi” të Isa Qosjes. Për publikun u bë i njohur edhe me rolet në serialet televizive “Familja moderne”, “Kafeneja jonë” dhe “Rexhepovitët dhe Mahmutovitët”. Sh. Istrefi është aktiv edhe si producent në kuadër të “CMB Production”, ku u realizua seriali televiziv “Kafeneja jonë” dhe në kompaninë “ISSTRA kreative factory”, ku u realizua filmi artistik “Tri dritare dhe një varje” në regji të Isa Qosjes. Punon si mësimitdhënës i lëndës së diksionit në Fakultetin e Arteve të UP-së. (Fadil Hysaj)

ISUFI Ahmet (1961-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), politikan. Lindi në Gjyrishec të Kamenicës. Si nxënës u përfshi në lëvizjen ilegale, në organizatën Lëvizja për Re-



AHMET ISUFI

publikën e Kosovës në Jugosllavi. Në vitin 1983 u burgos dhe u dënua me 6 vjet burg. Pas daljes nga burgu (1989) vazhdoi angazhimin në aktivitete politike kombëtare. Me daljen në skenë të UÇK-së, u angazhua për themelimin e celulave të saj në Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë. Pas konsolidimit të UÇK-së u emërua komandant i Zonës Operative të Karadakut, detyrë që e kreu deri në përfundimin e luftës. Pas transformimit të UÇK-së u angazhua në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. Në vitin 2000 iu bashkua Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe u zgjodh në funksione të rëndësishme brenda partisë. Si nënkryetar i AAK-së, në tri legjislaturat e periudhës 2001-2010 u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës. Më 2001 u zgjodh ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, ndërsa pas zgjedhjeve të vitit 2004, me formimin e koalicionit me kryeministër Ramush Haradinajn, mori sërish këtë dikaster. Por me ngritjen e aktakuzës nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës ndaj kryeministrit Haradinaj në mars të vitit 2005 dha dorëheqje nga pozita e ministrit. Vazhdoi të ushtrojë funksionin e nënkryetarit në AAK. (Bedri Muhadri)

ISUFI Elmaz (1970-). Gazetar. Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit. Mbaroi studimet për

pedagogji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studioi edhe për gazetari. Në vitin 1997 u angazhua gazetar-reporter në të përditshmen “Koha ditore”. Në vitin 2005 u emërua redaktor i sportit në këtë gazetë, ndërsa më vonë redaktor i ekonomisë dhe redaktor përgjegjës i gazetës “Koha ditore”. Ka qenë edhe udhëheqës i Bordit të Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës. (Leutrim Mustafa)

ISUFI-KOJA Fitore (1982-). Piktore. Lindi në Gjilan. Kreu shkollimin fillor e të mesëm në vendlindje, studimet e larta për pikturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (2004). Organizoi ekspozita personale në Gjilan (2000), në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare Universitare (2009), në Shkup, në Galerinë “Çifte Hamam” (2012), pastaj në Prishtinë (2014) dhe në Galerinë “Miza” në Tiranë (2015). Mori pjesë në disa ekspozita kolektive në Kosovë, Shqipëri, Itali, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Bullgari, Suedi, Francë etj. Gjithashtu ishte kuratore e ekspozitave të arteve pamore dhe mori pjesë në shumë projekte artistike brenda dhe jashtë vendit. Tradita, miti, lufta, problemet e gjinisë, të transformimeve, të kontrasteve ndërmjet të kaluarës e të tashmes, si dhe shumë aspekte të tjera ekzistenciale e karakterizojnë hulumtimin vizual dhe krijimtarinë e saj artistike. Është fituese e çmimit “Artistët e së nesërme IV” në Prishtinë (2006). (Ilir Muharremi)

ITALIANIZMAT. Fjalë a shprehje të huazuara nga italishtja. Depërtimi i fjalëve të gjuhës italiane në gjuhën shqipe ka ardhur si rrjedhojë e marrëdhënieve të italianëve me popullsinë shqiptare. Si cak kohor për fillimin e depërtimit të italianizmave në gjuhën shqipe merret zakonisht shek. X i erës sonë. Huazimet italiane të shqipes dallojnë në përgjithësi nga elementi latin. Ato kanë pësuar shumë më pak ndryshime fonetike dhe kuptimore sesa elementet prej burimit latin dhe, përveç kësaj, italianizmat, në shumicën e rasteve, nuk janë përhapur në të gjitha të folmet e shqipes, kurse fjalët prej burimi latin kanë pasur në përgjithësi një përhapje më të gjerë. Huazimet më të vjetra nga italishtja, në shumicën e rasteve, kanë depërtuar nëpërmjet gjuhës së folur, kurse italianizmat e reja kanë hyrë kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar ose nëpërmjet shtresës së shkolluar të popullsisë. Edhe huazimet nga italishtja, që kanë depërtuar kryesisht në zonat

bregdetare (sidomos nëpër qytete), u takojnë periudhave kohore të ndryshme. Më të vjetra janë ato që kanë depërtuar relativisht herët nga venecianishtja, si *monedhë, vidhë, manestër, adhuroj* etj., ndërsa huazime më të reja janë sidomos fjalët e termat e lundrimit, të teknikës, të shkencës e të arteve, të cilat kryesisht kanë depërtuar gjatë tre shekujve të fundit, si: *barkë, vapor, vel, rem, shirok, timon, freno, torno, tornitor, freza, kimi, muzikë, bas, soprano* etj. Disa nga këto fjalë janë ndërkombëtarizuar. (Kadire Binaj)

IVAJA. Fshat në komunën e Kaçanikut, rreth 7 km në juglindje të qendrës komunale. Është vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë. Shtrihet në lartësi mesatare mbi-detare 700-1000 m, me sipërfaqe 743 ha. Si vendbanim përmendet që nga viti 1389. Numri i popullsisë në vitin 2011 ishte 596 banorë, ndaj 488 banorë në vitin 1948. Dendësia e popullsisë është 80 b/km². Veprimtari kryesor ekonomike është blegtoria. Është qendër e bashkësisë lokale për vendbanimet Strazhë, Kotlinë dhe Gajre. Ka shkollën 9-vjeçare. (Shpend Agaj)

IVANAJ Nikollë (1879-1951). Veprimtar i lëvizjes kombëtare, publicist. Lindi në Triepsh të Grudës. U shkollua në Beograd, Zagreb dhe Vjenë. Më 1905 filloi të botojë në Dubrovnik



NIKOLLË IVANAJ

gazetën “Shpnesa e Shqipnisë”. Pas fitores së revolucionit xhonturk më 1908 ndërpreu botimin e gazetës dhe u kthye në Shqipëri, ku u mor me organizimin e kryengritjeve kundër-osmane të viteve 1910-1912. Në raportin e nëntorit të vitit 1909, nga udhëtimi i tij tetëdhjetë ditësh prej Ulqinit deri në Shkup, N. Ivanaj përshkroi në detaje gjendjen e krijuar në vilajetin e Kosovës. Gjatë këtij udhëtimi ai ishte takuar me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Nexhip Dragën, Binak Alinë, të cilët, sipas tij, punonin për përhapjen e ideve të Rilindjes dhe hapjen e shkollave shqipe. Pas shpalljes së Pavarësisë, N. Ivanaj i vazhdoi përpjekjet për mbrojtje e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Shqiptarët e Amerikës e zgjodhën delegat për të mbrojtur çështjen shqiptare në

Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920). Pas Kongresit të Lushnjës doli haptazi si përkrahës i Republikës. Pikëpamjet e tij i shfaqti si deputet i Shkodrës në Parlamentin Shqiptar dhe si publicist në gazetat që drejtoi vetë: “Lidhja Kombëtare” (1915), “Koha e re” (1919, 1925), “Republika” (1923-1925). Përkrahu Revolucionin e Qershorit, ndërsa pas kthimit të Zogut në pushtet, u largua nga vendi. N. Ivanaj la dy vëllime me dokumente: “Historia e Shqipëniës së Ré” (pjesa I, 1943; pjesa II, 1945). Pas Luftës së Dytë Botërore u kthye në Shqipëri. Vdiq në Tiranë. (Teki Kurti)

IVANOVA Julia (Julia Vladimirovna Ivanova) (1922-2006). Etnografe ruse. Kreu studimet për histori dhe etnografi në Universitetin e Moskës (1943-1946). Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Institutin e Etnografisë të Akademisë së Shkencave. Më pas mbrojti disertacionin për Kanunin e Lekë Dukagjinit si një burim etnografik për jetën shoqërore të Shqipërisë së Veriut (1954). Mbajti mësimë në disa shkolla të larta të Leningradit dhe të Moskës. U mor me studimin e traditave, të jetës shoqërore dhe të normave të së drejtës zakonore ndër shqiptarët dhe grekët. Në periudhën 1956-1960 ndërmori një serë ekspeditash të gjata në zonat malore të Shqipërisë (Dukagjin, Malësi e Madhe, Mirditë etj.). Hartoi dhe botoi versionin e plotësuar të Kanunit të Lekë Dukagjinit me përkthim në gjuhën ruse dhe komente (1994). Për këtë kontribut u dekorua me urdhrin “Naim Frashëri” nga presidenti i Republikës së Shqipërisë. U kushtoi vëmendje diasporave shqiptare dhe greke në ish-BRSS. Botoi punime shkencore, përfshirë monografitë “Shqipëria e Veriut në shek. XIX – në fillim të shek. XX. Jeta shoqërore” (Severnaja Albaniya v XIX-naçale XX v. Obščestvennaja žiznj, Moskë 1973) dhe “Punët dhe festat e fshatarëve shqiptarë” (Trudi i prazdniki albanskih krestjan, Moskë 2004). Monografia e fundit “Shqiptarët dhe fqinjët e tyre” (Albancy i ih sosedy, Moskë 2006) doli nga shtypi pas vdekjes së saj. (Marija Morozova)

IVETIC Exhidio (Egidio) (1965-). Historian italian, profesor i historisë moderne në Universitetin e Padovës. U diplomua për histori në Universitetin e Padovës më 1990. Pas studimeve të gjuhës sllave në të njëjtin universitet, kreu doktoratën në Universitetin

e Venecias dhe më pas mori titullin e doktorit të filozofisë në Universitetin e Milanos. Që nga viti 2000 ligjëron historinë e Europës Lindore në Universitetin e Padovës. Është edhe anëtar i Institutit të Shkencave, Arteve dhe Letrave të Venetos. Ka botuar monografitë: “Popullsia e Istrias në kohët moderne” (1997); “Përtej deti, Istria nën pushtetin e fundit venecian” (2000); “Luftërat ballkanike” (2006, u botua edhe shqip në Tiranë, më 2008); “Jugosllavia e ëndërruar. Origjina e jugosllavizmit” (2012); “Një kufi në Mesdhe. Adriatiku Lindor midis Italisë dhe Sllavisë (1300-1900)” (2014) etj. (Teki Kurti)


IVOVIQ (Ivović) Petar (1926-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Berane (Ivangrad) në Mal të Zi. Shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Cetinë dhe Kragujevc, studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1952). Punoi agronom në disa kooperativa bujqësore në Vojvodinë. Punësohet asistent për agrokimi dhe udhëheqës i fushave eksperimentale në Institutin për Hulumtime Shkencore Bujqësore në Pejë (1954). Për qëllime specializimi qëndroi në Entin e Agrokimisë në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit dhe në Holandë. Tezën e disertacionit e mbrojti në vitin 1964. Ka punuar profesor në Shkollën e Lartë Bujqësore në Prishtinë (1961) dhe ka bërë studime pedologjike dhe agrokimike të tokave të reja të përfutuara nga shpyllëzimet në Kosovë. Ka publikuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale, ndër të cilat edhe

“Sipërfaqet e reja të hapura në Kosovë”. Në vitin 1970 kalon me detyrë në Institutin e Tokave në Beograd. (Bashkim Kabashi)

IZAIRI Remzi (1945-). Mjek, internist, reumatolog, profesor universitar. Lindi në Çegan të Gostivarit, shkollën fillor e kreu në vendlindje, të mesmen në Gostivar. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Beograd (1972). Në vitin 1974 u punësua në Klinikën Interne të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Kreu specializimin gjithashtu në Beograd. Më 1978 themeloi shërbimin e reumatologjisë në Klinikën Interne në Prishtinë. Magjistroi në fushën e reumatologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd dhe u zgjodh asistent në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1980). Punimin e doktoraturës gjithashtu nga reumatologjia e mbrojti në vitin 1984 në Prishtinë, më pas u zgjodh docent i lëndës mjekësia interne, pastaj profesor inordinar dhe më 1998 profesor ordinar. Shumë vjet ishte kryeredaktor i revistës shkencore “Medicus”, revistë e Shoqatës së Mjekëve, Stomatologëve dhe Farmacistëve Shqiptarë të Maqedonisë. Është autor i teksteve “Reumatologjia klinike” dhe “Doracak për diagnozën dhe mjekimin e sëmundjeve reumatike”. Gjithashtu ka përkthyer dy tekste nga mjekësia interne dhe është autor i shumë punimeve shkencore dhe profesionale, si dhe pjesëmarrës në shumë kongrese e simpoziume shkencore. (Ahmet Brovina)

J

JAGXHIU Fetah (1937-). Inxhinier i ndërtimtarisë, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e rregullta dhe ato



FETAH JAGXHIU

pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Ndërtimtarisë të Universitetit të Zagrebit. Me të kryer studimet, zë punë në ndërmarrjen ndërtimore “Shar” të Prizrenit dhe më pas në Shkollën e Lartë Teknikë në Prishtinë. Me themelimin e Fakultetit Teknik (1965) u zgjodh asistent, më 1970 docent dhe në periudhën 1971-1973 bëhet dekan i Fakultetit Teknik. Në vitin 1976 botoi tekstin e parë universitar në gjuhën shqipe në Kosovë nga fusha e shkencave teknike, “Mekanika I”. Në vitet në vijim botoi tekste të tjera universitare: “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika I” (1978), “Mekanika” II dhe III (1980, 1985), “Rezistenca e materialeve” I dhe II (1995, 2000) etj. Qëndroi për studime në Krakov të Polonisë dhe më 1982 mbrojti tezën e doktoratës në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Po atë vit u zgjodh profesor inordinar dhe më 1987 profesor ordinar. Ishte dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të UP-së (1990-1994) dhe kreu detyra me përgjegjësi në organet drejtuese të UP-së. Është autor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale të botuara brenda dhe jashtë vendit. (Misin Misini).

JAGXHIU Nexhmedin (1929-1996). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti. Lindi në Prizren, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesmen në Novi-Sad



NEXHMEDIN
JAGXHIU

Teknik si mësimdhënës i lëndëve profesionale të makinerisë. Më pas u zgjodh docent (1970) dhe ishte titullar i lëndëve vizatimi teknik dhe stabilimentet e uzinave. Për shumë vjet mbajti ligjërata edhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Projektoi shumë uzina e fabrika në Prizren, Gjiilan, Ferizaj etj., mori pjesë në një sërë projektsh investive, si bashkëpunëtor i Institutit Ekonomik dhe u angazhua si ekspert në komisione të shumta profesionale në Odën Ekonomike dhe në Këshillin Ekzekutiv të KSA të Kosovës. N. Jagxhiu konsiderohet veteran i arsimit teknik në Kosovë. (Musli Bajraktari)

JAHA Luan (1967). Aktor. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP). Realizoi një sërë rolesh në teatër dhe film. Njihet si



LUAN JAHA

aktor që me sukses kombinoi ironinë me ekspresionin, tragjikomedinë me dramën psikologjike. Realizoi me sukses role në shfaqjet: “Ëndrra e qenit” (2002) në regji të I. Qosjes, “Guxim për vrasje” (2007), “Togeri i Inishmorit” (2008), “

(1949), kurse studimet në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Zagrebit (1962). Punoi në ndërmarrjen “Remont” në Mitrovicë (1957), e më pas në fabrikën “Famipa” në Prizren. Punën pedagogjike e filloi në Fakultetin

Fluturimi mbi folenë e qyqes”(2000) në regji të I. Bokshit, “Pallati i ëndrrave”(2002) në regji të A. Bashës, “Orestia” (2003) dhe “Mbreti Lir” (2005) në regji të F. Hysajt. Profili i tij si aktor u formësua sidomos me rolet: Vladimiri në “Duke pritur Godonë”, (Çmimi Special i jurisë për shfaqje në Festivalin e Sarajevës,1997), Plakushi në “Karrigat” (1998) dhe Regjisor i në “Shfaqja e fundit” (2001), të tria këto në regji të F. Hysajt. Po me aq sukses L. Jaha realizoi mbi 20 role në filma shqiptarë dhe të huaj, si “Kukumi” të I. Qosjes (çmimi i parë në Festivalin e Filmit Shqiptar, 2005), “Koha e kometës” të Fatmir Koçit (2007), “Falja e gjakut” të Joshua Marston-it (Ariu i argjendte për skenar në Berlinare, 2011), “Burrneshat” të Laura Bispurit (Berlinale, 2015), “Tri dritare dhe një varje” të I. Qosjes (çmimi Cineuropa në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Sarajevë, 2014), “Praneverë e harrur në fshatin e harruar” të K. Bektshit etj. Për publikun e gjërë L. Jaha u bë i njohur edhe përmes serialit televiziv “Familja moderne”. Punoi si mësimdhënës i aktrimit në Fakultetin e Arteve të UP-së. (Fadil Hysaj)

JAHA Sabit (1952-). Publicist dhe letrar. Lindi në Stagovë të Kaçanikut. Arsimin fillore e mori në vendlindje dhe në Kaçanik të Vjetër, shkollën e mesme (Normalen) e kreu në Ferizaj. Studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Një kohë të gjatë ishte gazetar, redaktor dhe ndihmës kryeredaktor i revistës së arsimit “Shkëndija” në Prishtinë. Është edhe botues, pronar i shtëpisë botuese “SAS” në Prishtinë. S.Jaha filloi të merrej me shkrime qysh në shkollën e mesme. U mor, kryesisht, me letërsinë për fëmijë dhe me çështje arsimore. Publikoi shumë vepra, ndër të cilat: “Shamia e lotëve” (1998), “Peripecitë e Tul Tulanit” (2000), “Fanarët e fortunës” (2007), “Qiriazët dhe shkolla shqipe” (2007), “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë në Kosovë 1953-2008” dhe “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë për të rinj dhe fëmijë në Kosovë 1953-2013” (2014) etj. (Hajrullah Koliqi)

JAHA Tahir (1913-2003). Shkrimtar. Lindi në Babaj, komuna e Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në Krumë, ndërsa gjimnazin e vazhdoi në Shkodër. Ishte pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare. Punoi në institucione të ndryshme, por më gjatë në Kryqin e Kuq të

Kosovës. Në vitet e luftës shkroi dhe botoi në shtypin ilegal disa poezi programatike dhe poemën “Çlirimtarët” (1943-1944). Më 1964 në revistën “Jeta e re” botoi prozën “Tyton oxhaku i Sadik Micanit”, ndërsa më 1967 botoi përmbledhjen e poezive “Lulet e stinëve”, si dhe dramën “Eja, eja” dhe “Dialog kohe”, që i botoi në vitin 1968. Në shkrimet e tij letrare trajtoi temën e luftës dhe atë sociale. Vepra e tij letrare bën pjesë në letërsinë shqipe të Kosovës të fazës së parë pas Luftës së Dytë Botërore. (Isak Shema)

JAHIU Jahi (1953-). Dramaturg. Lindi në Sllubicë të Gjilanit. Shkollën e mesme e kreu në Gjilan, ndërsa studimet për dramaturgjë i mbaroi në Fakultetin e Arteve Dramatike të Universitetit të Beogradit. Në periudhën 1971-1975 ishte i angazhuar në Teatrin e Gjilanit, ndërsa më pas në programin artistik të Televizionit të Prishtinës. Pas vitit 1999 sërish u kthye dramaturg në Teatrin e Gjilanit, ku në vitet 2004-2009 ishte drejtor i këtij teatri. Është autor dhe dramaturg i disa veprave skenike dhe televizive, si dhe regjisor i disa shfaqjeve teatrore. (Selman Jusufi)

JAHJA Pasha (?-1507). Pushtetar i lartë, komandant ushtarak dhe themelues vakëfesh. Lindi në Leshan të Suharekës, ku u mor devshirm si djaloshi i krishterë në kohën e mbretërimit të sultan Mehmetit II. Karrierën ushtarake e filloi si komandant i akinxhinjve. Ishte bejlerbej i Bosnjës dhe i Rumelisë. Njihet si njëri nga themeluesit më të mëdhenj të vakëfeve në trojet shqiptare. Përveç tjerash, në një lagje të Shkupit, që mori emrin e tij, ngriti një kompleks objektësh “kul-rije”, që përbëhej nga xhamia, e cila edhe sot qëndron, medreseja dhe imareti, pastaj karvansarajin, hanet etj. Ishte i martuar me vajzën e sultan Bajazitit II, princeshën Hatixhe. La pas vetes dy djem: Gazi Ahmet beun dhe Bali Beun, të cilët arritën pozita të rëndësishme politike dhe ushtarake në Perandorinë Osmane. (Nehat Krasniqi)

JAHJAGA Atifete (1975-). Presidente e Republikës së Kosovës. Lindi në Rashkoc të Gjakovës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, kurse studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (UP) i përfundoi në vitin 2000. Në periudhën 2006-2007 përfundoi certifikimin postdiplomik në



ATIFETE JAHJAGA

menaxhimin policor dhe të drejtën penale në Universitetin e Leicesterit në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa certifikimin postdiplomik në shkenca kriminalistike në Universitetin e Virgjini në SHBA në vitin 2007. Vazhdoi studimet e magjistraturës në drejtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të UP-së. Që nga themelimi i Policisë së Kosovës, në fillim të vitit 2000, ka shërbyer si zyrtarë rangjesh të ndryshme. Fillimisht shërbeu si police, duke përparuar në nivel rajonal dhe në atë të Shtabit të Përgjithshëm. Prej shkurtit të vitit 2009 deri në prill 2011 ishte zëvendës drejtoresh e përgjithshme e Policisë së Kosovës. Gjatë karrierës së saj të mëhershme në Policinë e Kosovës ka shërbyer në pozita të ndryshme në zbatim të rendit dhe të ligjit në Njësinë e Standardeve Profesionale, pastaj ndihmëse e zëvendës drejtorit të Policisë së Kosovës, ndihmëse e shefit të burimeve njerëzore, ndihmëse ekzekutive speciale e zëvendëskomisarit për Administratën e Policisë së Kosovës, zëvendëskomandante për Polici Kufitare të Policisë së Kosovës, kryesuese e departamentit të trajnimeve, ndihmëse e zëvendëskomisarit të Policisë së Kosovës për Polici Kufitare, ndihmëse e zëvendëskomisarit të Policisë së Kosovës për personel dhe trajnim etj. Atifete Jahjaga u zgjodh presidente e Republikës së Kosovës më 7 prill 2011. Është presidentja e dytë e zgjedhur sipas Kushtetutës që nga shpallja e Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008. Mandatin pesëvjeçar e përfundoi më 7 prill 2016. (Qerim Qerimi).

JAKA Enver (1956-). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Gjakovë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1980). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1981 dhe pjesëmarrës në ekspozitat e saj, i vlerësuar si portretist dhe peizazhist me motive burimore të traditës. Ekspozitën e parë vetjake e hapi në Gjakovë (1987), pastaj ekspozoi në Prizren (1996), ndërsa nga ekspozitat e përbashkëta veçohet ajo e vitit 1981 "Paleta e të rinjve të Jugosllavisë" në Vërbas, më 1983 "Portreti jugosllav" dhe ekspozita "Formati i vogël i portretit" më 1987 në Split. Mori pjesë

edhe në ekspozita të tjera të përbashkëta të Lidhjes së Shoqatave të Artistëve Figurativë të ish-Jugosllavisë. (Tahir Emra)

JAKA Fatmir (1944-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të



FATMIR JAKA

Beogradit (1972). Kreu studimet pasuniversitare në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Zagrebit (1981), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1994. Në vitin 1975 zgjidhet asistent në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së për lëndën makinat bujqësore dhe në vitet vijuese i merr të gjithë titujt universitarë. Për qëllime studimi qëndroi në Belgjikë, në Universitetin "Gent" (1980). Ka botuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale në revistat e ndryshme në vend dhe në botën e jashtme. (Xhevdet Elezi)

JAKA Latif (1901-1949). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, ku kreu edhe shkollën fillore shqipe (1917). Kreu edhe shkollën bujqësore në Lushnjë dhe kursin pedagogjik në Shkodër (1925). Emërohet mësues në zonat e Shqipërisë Veriut, në Golaj e Borje, pastaj në Bicaj e Tropojë. Më 1942 hapi shkollën e parë shqipe në Junik, në vitin 1944 u transferua në Gjakovë. Një vit më vonë, "për shkaqe politike" u pushua nga puna. (Jusuf Meqa)

JAKA Qamile (1941-2007). Mjeke, stomatologe, profesore universiteti. Lindi në Tropojë, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Gjakovë, u diplomua në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1967). Mbaroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1981), ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (1986). Gjatë viteve 1967-1980 punoi në Poliklinikën e Dhëmbëve të Shtëpisë së Shëndetit në Prishtinë, e më pas në degën e stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializoi në lëmin e ortopedisë së nofullës. Ndërkohë, më 1979 u zgjodh asistente, më pas mori titujt e tjerë universitarë

dhe më 2001 u zgjodh profesor ordinar i lëndës ortopedi e nofullës dhe fytyrës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mori pjesë në shumë kongrese e simpoziume dhe publikoi një sërë punimesh shkencore. Ishte laureat i disa mirënjohjeve dhe dekoratave. (Fatmir Dragidella)

JAKA Ymer (1937-2009). Studiues i letërsisë, profesor universiteti, përkthyes. Lindi në Tropojë, Shqipëri. Kreu shkollën fillore dhe Gjimnazin e ulët në Gjakovë, Normalen në



YMER JAKA

Prishtinë. Një kohë ishte mësues në Deçan, pastaj studioi për gjuhë e letërsi frënge në Beograd, ku u diplomua më 1960. Punoi në Radio-Prishtinë (1963-64), më pas ishte redaktor përgjegjës i Entit të Botimeve Shkollore në Prishtinë (1965-1967). Në Beograd regjistroi studimet pasuniversitare (1967) dhe qëndroi në Paris gjatë viteve 1968-1970, ku bëri kërkime për doktoratën “Skënderbeu në letërsinë frënge”, të cilën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1977). Ishte ligjërues, pastaj profesor inordinar në degën e gjuhës dhe të letërsisë frënge në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Në vitet 1974-1981 ishte sekretar i Sekretariatit Krahinor për Arsimit, Shkencë e Kulturë. Nga viti 1983 punoi si këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Si specialist i romanistikës u mor me studime krahasimtare mbi lidhjet kulturore e historike shqiptaro-frënge, në veçanti me Skënderbeun në letrat dhe në historiografinë frënge. Nga këto fusha botoi tri vepra: “Lidhjet letrare shqiptaro frënge” (1979), “Skënderbeu në letërsinë frënge” (1990) dhe “Skënderbeu në historiografinë frënge” (2000), si dhe artikuj e studime në revista dhe kumtesa në tubime shkencore. U mor dhe me përkthime nga frëngjishtja (Prust, Zhid, Dekart, Ruso, Tokëvilë, Sartër, Volter etj). Përktheu në shqip edhe romanin “Bardha e Temalit” të Pashko Vasës. (Eqrem Basha)

JAKUPAJ Muharrem (1950-). Biolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Skivjan të Gjakovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për biologji në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore

të Universitetit të Prishtinës (1975), ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të po këtij universiteti (1991). Studimet e doktoratës, në fushën e shkencave biomedicinale, i kreu gjithashtu në Fakultetin e Mjekësisë (1996). Punoi mësimdhënës i biologjisë në Gjimnazin “Sami Frashëri” dhe në Shkollën e mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë. Një periudhë punoi bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Fiziologjisë të Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 1991 zgjidhet asistent në Fakultetin e Mjekësisë dhe më pas avancohet në të gjithë titujt universitarë (2009) për lëndët biologji qelizore dhe biologji molekulare. Për studime shkencore qëndroi në Cleveland, Ohio të SHBA-së. Publikoi disa punime shkencore brenda e jashtë vendit dhe mori pjesë në konferenca të ndryshme shkencore. (Behxhet Mustafa)

JAKUPI Ahmet (1945-). Regjisor. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për regji i kreu në Universitetin e Pragës. Një periudhë punoi në Teatrin e Prishtinës, ndërkaq më



AHMET JAKUPI

pas u angazhua në Teatrin Shqiptar në Shkup, ku vazhdon të punojë si regjisor i rregullt. Deri tani realizoi një sërë regjish teatrore të veprave nga dramturgjia e huaj dhe ajo shqiptare. Ndër regjitë më të njohura të tij janë ato të veprave: “Burri burrë” dhe “Zi e më zi” të K. Floqit, “Drita e ditës” e A. Rusit, “Shi në plazh” e T. Laços, “Hamleti” i U. Shekspirit, “Henriku IV” i L. Pirandelos, “Gof” i A. Pashkut, “Zbutësi i njerëzve” nga Teki Dërvishi etj. Bëri regjinë e disa filmave dokumentarë dhe të emisioneve të ndryshme televizive. Gjithashtu dha kontribut në afirmimin dhe zhvillimin e artit skenik, veçanërisht në Maqedoni. Si veçanti e regjisë së tij konsiderohet prirja ndaj groteskut dhe spektaklit. Është fitues i disa çmimeve për regji në festivale të ndryshme në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. (Salajdin Salihu)

JAKUPI Ali (1943-2013). Ekonomist, publicist, letrar, aktivist politik, profesor universiteti. Lindi në Shalë të Artakollit të Vushtrrisë, arsimin bazë e mori në Vushtrri dhe në Mitrovicë, ndërsa Fakultetin Ekonomik e kreu në



ALI JAKUPI

Prishtinë. Studimet pasuniversitare në fushën e marketingut i mbaroi në Universitetin e Zagrebit. Më pas doktoroi në shkencat ekonomike. Ishte udhëheqës në firma të ndryshme, përfshirë edhe NGBG "Rilindja". Një kohë ka qenë ministër i Tregtisë dhe i Industrisë në Qeverinë e Kosovës, ndërsa ka qenë profesor i rregullt i lëndës së marketingut në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Tetovës. Që herët u mor me shkrime letrare, duke lënë të botuara disa vepra në fushën e prozës dhe të poezisë ("Zgjimi i fjalës", "Hapësirë rrethore", "Nyjëzim", "Në Itakë" etj.) Botoi edhe monografi e vepra publicistike nga fusha e ekonomisë dhe e politikës: "Finalizimi dimension i strategjisë së zhvillimit të ekonomisë së KSA të Kosovës" (monografi, 1985); "Dy shtete shqiptare dhe bashkimi kombëtar" (1995), "Për ata Kosova është ëndërr" (1998) etj. Ishte i përkushtuar edhe në punë shkencore në fushën e ekonomisë, ku ka lënë të botuara tekstet universitare "Bazat e marketingut" dhe "Marketingu ndërkombëtar". (Nail Reshidi)

JAKUPI Arta (1979-). Inxhinier e arkitekturës, mësimdhënëse universitare. Lindi në Prishtinë, shkollimin fillor, të mesëm dhe studimet i kreu në Prishtinë në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës (2005). Ndoqi studimet pasuniversitare në "Buahaus Kolleg-Dessau" të Gjermanisë më 2006. Mbaroi studimet e doktoratës nga lëmi i urbanizmit më 2012 po në Gjermani. Në vitin 2007 u zgjodh asistent në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (UP), ndërkaq në vitin 2014 u zgjodh profesor asistent për lëndët: vizatim arkitektonik, vizatim i lirë, estetika e hapësirës dhe gjeometria deskriptive. Është autore e monografisë (disertacionit) në anglisht "Efekti i pranisë së komunitetit ndërkombëtar në zhvillimin urban pas konfliktit në qytetin e Prishtinës, rasti i Kosovës" (2013). Botoi disa punime shkencore në revista ndërkombëtare dhe mori pjesë në disa konferenca profesionale dhe shkencore. (Flamur Doli).

JAKUPI Hajdar (1907-1982). Veteran i arsimit dhe i sportit kosovar. Lindi në Gjakovë.

Arsimimin e filloi e kreu në Gjakovë dhe e vazhdoi në Shkodër dhe në Korçë. Në vitin 1927 regjistrohet në Akademinë e Edukatës Fizike në Itali, më 1931 emërohet mësues në Fier, kurse më vonë kaloi në Shkollën e Mesme Teknike në Tiranë. Më 1935 certifikohet si arbitër futbollit, i cili në vitin 1948 referon garat sportive të Ballkaniadës të mbajtura në Tiranë. Nga viti 1948 ishte mësimdhënës i edukatës fizike, përkatësisht i gjuhës frënge në Prishtinë dhe Drenas. Përveç punës pedagogjike, H. Jakupi ishte edhe organizator i manifestimeve të ndryshme sportive në Kosovë. Për kontributin e tij mori disa mirënjohje, ndër të cilat edhe dekoratën "Naim Frashëri" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë (1994). (Nijazi Zylfiu)

JAKUPI Isa (1943-). Pedagog, kompozitor. Lindi në Gjiilan. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, u diplomua në Akademinë e Muzikës, drejtimi teorik-pedagogjik në Beograd. Drejtoi Shoqatën e studentëve "Përpjekja" me orkestrinë e këngëtarë. Pas studimeve punoi si mësimdhënës i muzikës në Shkollën Normale, i metodikës së muzikës në Akademinë Pedagogjike në Gjiilan. Ishte ndër themeluesit e Shkollës së Ulët (1979) dhe më pas të Shkollës së Mesme të Muzikës në këtë qytet. Ka kompozuar afro 100 këngë në frymën popullore dhe po aq për fëmijë. Albumet: "Kam një harmonikë", "Një maçok", "Xhepagrisuri", "Shqiponjat e malit". Udhëhoqi SHKA-të "Drita" dhe "Zenel Hajdini", me të cilat mori pjesë në koncerte e manifestime në Kosovë dhe jashtë saj. Këngët e shpërblyera: "Treni" (Akordet e Kosovës), "Nënë kam, por jam jetim" (Shkodër), "Valsi veror" (Shkup), "Xhepagrisuri ngucakeq" (Shou-fest), "Mos, deti s'u bë kos" (Norvegji), "Mollë e kuqe është Kosova" (Podujevë), "Kënga e Gjakovës" (Peja '96). Është autor shkrimesh mbi problematikën e mësimdhënies dhe recensues tekstesh shkollore. (Arnisa Rexhepi)

JAKXHIU Salajdin (1933-2013). Mjek, pneumoftiziolog, primarius. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjysmëmaturnë i kreu në vendlindje, ndërsa maturën e mbaroi në Novi-Sad (1953). Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit (1960). Më 1966 specializoi në lëmin e ftziologjisë në Beograd. Për kontributin e çmuar në aftësimin e kuadrit mjekësor dhe publikimin

e punimeve profesionale, më 1984 Komiteti Krahinor i Shëndetësisë i dha titullin primarius. Ka dhënë kontribut të çmuar në parandalimin e tuberkulozit në komunat Prizren, Suharekë dhe Rahovec. Ishte për tre mandate kryetar i Shoqatës së Ftziologëve të Kosovës dhe gjatë periudhës 1974-1978 kryetar i Lidhjes së Pneumoftziologëve të Jugosllavisë. Disa vjet ishte drejtor i Qendrës Rajonale të Prizrenit. Pas largimit nga puna më 1990, për 4 vjet ishte drejtor profesional i ambulancës “Nënë Tereza” në Prizreni që nga hapja e saj. (Sejdullah Hoxha)

JANKAJ Zef (Fran) (1927-1999). Mbledhës dhe studiues i folklorit, klerik. Lindi në Ljare të Krajës. Kreu arsimin fillor në vendlindje, gjimnazin në Dubrovnik e në Split. Mbaroi studimet për filozofi dhe teologji në Fakultetin Teologjik të Dubrovnikut. Meshën e parë e celebroidi në vendlindje, Ljare të Krajës. Ishte anëtar i Provincës Françeskane të Shën Jeronimit, ku kreu shërbimin në shumë vende të Dalmacisë. Në Dioqezën e Tivarit erdhi në vitin 1962, si famullitar në Triesh të Malësisë së Madhe. Ishte edhe administrator i famullisë së Kojës dhe kapelan në Podgoricë. U mor me vjeljen dhe studimin e folklorit shqiptar. Në vitet shtatëdhjetë bëhet bashkëpunëtor i rregullt i Institutit Albanologjik të Prishtinës, duke mbledhur krijimtarinë gojore në viset e Ljarës, Shestanit të Krajës, Trieshit, Hotit e Grudës dhe të Kojës. Punimet shkencore dhe materialet folklorike i botoi në revistën shkencore “Gjurmime albanologjike”, seria e folklorit dhe e etnologjisë. Ishte meshtari i parë që celebroidi meshën e shenjtë në gjuhën shqipe pas Konkilit të dytë të Vatikanit. Punimet i tij u përmbledhën dhe u botuan në veprën “Krijimtari gojore (Krajë-Malësi)” (2007). (Ylberza Halili)

JANSON Bernd (1940-). Filolog gjerman nga Hajdelbergu. Kreu studimet për filologji latine dhe angleze në Hajdelberg, ku u doktorua më 1984. Studioi gjuhësi indoeuropiane dhe dha mësim në shkollat e larta të Baden-Vyrtenbergut. Për studimet për shqipen kanë rëndësi hulumtimet e tij të gjera për zhvillimet fonetike dhe për etimologjitë e fjalëve që lidhen me rotacizmin dhe dallimet midis dy kryedialekteve të shqipes mbi këtë bazë. Mendon se rotacizmi në shqipen do të ketë ndodhur në shek. VIII-X dhe ka përfshirë

fjalët e trashëguara, huazimet greke, latine dhe pjesërisht sllave. Vepra e tij “Hulumtime etimologjike dhe kronologjike për kushtet e rotacizmit në shqipen” e botuar më 1986, paraqet studimin themelor të këtij ndryshimi fonetik të shqipes. (Rexhep Ismajli)

JANURA Petro (1911-1983). Studiues i shqipes, profesor. Lindi në Fier, u shkollua në Rumani dhe në Itali. Pas Luftës së Dytë Botërore jetoi në Maqedoni. Ishte burgosur në Tetovë dhe u dërgua në kampin e Prishtinës. Në Shkup punoi si profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Normalen e Shkupit, në Fakultetin e Filologjisë dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Ishte drejtor i gazetës “Flaka e vëllazërimit”. Botoi artikuj me kritikë letrare dhe historike për vepra dhe autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj. Ndër artikujt studimorë përmenden ato për dokumentet e para të shkrimit të shqipes, veçmas për “Perikopenë e Ugjillit”. La të botuara dy monografi: “Për historinë e alfabetit shqip” (1969) dhe “Migjeni” (1982). Ka qenë pjesëmarrës në Kongresin e Drejtshkrimit (1972). (Berton Sulejmani)

JANUZAJ Adnan (1995-). Futbollist. Lindi në Bruksel të Belgjikës. Ka prejardhje nga Kosova. Babai i tij, Abedini, lindi në Istog. Januzaj është mesfushor-sulmues dhe aktualisht luan për skuadrën angleze Manchester Junajted (Manchester United). Nisi karrierën si futbollist në vitin 2001 në FC “Brussels”. Aty luajti deri në vitin 2005, pastaj kaloi tek “Anderlehti” dhe luajti në këtë klub deri në vitin 2011. Talenti i tij ra në sytë e skautëve të “Manchesterit”, gjë që bëri kalimin e tij në këtë klub në vitin 2011, ku edhe vazhdon të luajë. Në vitin 2014 Januzaj vendosi t’i bashkohej përfaqësueses së Belgjikës, ndonëse kishte ftesë nga drejtuesit e futbollit shqiptar për t’iu bashkuar Shqipërisë. Me këtë skuadër përfaqësuese ishte edhe në Kampionatin Botëror “Brazil 2014”. Talenti i tij ra në sytë e skautëve të “Manchesterit”, gjë që bëri kalimin e tij në këtë klub në vitin 2011, ndërsa luajti si huazim te “Borussia Dortmund” në edicionin 2015/16. Në vitin 2016 huazohet te skuadra e njohur angleze “Sunderland”. (Leutrim Mustafa)

JANUZI Ahmed (1988-). Futbollist. Lindi në Vushtrri. Si i ri iu bashkua skuadrës “Kosova” të këtij qyteti dhe vetëm 18 vjeç debutoi në ekipin

e parë. Në shkurt të vitit 2007 kaloi te “Vorskla Poltava” në Ukrainë. Në edicionin e parë në futbollin e Ukrainës regjistroi nëntë gola. Është ende pjesë e “Vorskla Poltavas” dhe ka mbi 100 paraqitje, përfshirë këtu edhe ndeshjet e fazës së grupeve të Ligës së Europës. Ishte bashkëlojtar me Debatik Currin e Armend Dallkun si te “Vorskla” ashtu edhe te kombëtarja e Shqipërisë. U ftua nga përfaqësuesja A e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010 dhe luajti shtatë ndeshje, përfshirë edhe ato mënjane për “Euro 2012” me përfaqësuesen e Francës dhe të Rumanisë. Suksesin më të madh e ka arritur në edicionin 2008/2009, kur fitoi Kupën e Ukrainës me “Vorsklan”. (Arsim Maxhera)

JANUZI Ali (1956-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Sumë të komunës së Vushtrrisë. Punoi si teknik i elektrikut në “Elektrokosova”, në distribucionin e Vushtrrisë. Në vitin 1982 u dënua me 60 ditë burg për pjesëmarrje në demonstrata. Nga viti 1990 mori pjesë në aksionin për pajtimin e gjaqeve. Në vitin 1995 ra në kontakt me grupin e komandantit Adem Jashari dhe më pas u bë pjesëtar i UÇK-së. Në vitin 1997 u dënua në mungesë nga gjykata serbe me 15 vjet burg, me grupin e Adem Jasharit. Pas largimit të përkohshëm jashtë vendit, në fillim të vitit 1998 u kthye sërish në Kosovë, në Shalë të Bajgorës. Në shtator të vitit 1998 u emërua ndihmëskomandant në Brigadën 141 “Mehë Uka”, ndërsa nga janari i vitit 1999 ndihmëskomandant për moral në Zonën Operative të Shalës. (Emin Musa)

JANJEVA MESJETARE. Vendbanim i karakterit xehetar, që nga parahistoria dhe antikiteti. Gërmimet arkeologjike dëshmojnë eksploatimin e pandërprerë të xeheve që nga periudha e Mbretërisë Dardane, gjë që vazhdoi edhe në kohën e sundimit romak. Janjeva mesjetare i takonte basenit xehetar të Novobërdës. Është qytet i vetëm i Kosovës, i cili e ruajti karakterin mesjetar deri në ditët e sotme. Shënimin e parë mbi Janjevën mesjetare e hasim në vitin 1303, në një letër të papës Benedikti XI drejtuar argjipeshkvit të Tivarit. Po atë kohë në Janjevë përmendet famullia katolike. Por Janjeva u shqua si qytet dhe trevë ekskluzivisht xehetare, që nga fillimi i shek. XIV. Nga xeheroret e Janjevës nxirrej argjendi, ari e plumbi. Qyteti dhe xeheroret mbroheshin

nga kështjella e afërt në bjeshkën e Veletinit, e cila sot është në rrënoja. Xehetarët kryesisht ishin sasë, por edhe banorë të shumtë lokalë, të cilët vazhduan me këtë profesion edhe pas vendosjes së sundimit osman. Sikurse edhe në qytetet e tjera xehetare të Kosovës, në Janjevë kishte edhe shkritore. Burimet e kohës njoftojnë se tregtarët raguzanë kishin aty koloninë e tyre tregtare që nga fillimi i shek. XV. Disa tregtarë raguzanë u bënë pronarë apo bashkëpronarë të disa galerive të xeheroreve të Janjevës. Kolonia raguzane në Janjevë deri në mesin e shek. XV kishte mesatarisht nga 80-100 tregtarë. Raguzanët kishin edhe konsullatën e tyre, në të cilën brenda viteve 1423-1454 u ndërruan jo më pak se 49 konsuj. Konsujt raguzanë në raportet e tyre e vlerësonin lart cilësinë e argjendit të Janjevës, sepse veçori ishte argjendi i përzier me ar (*argentum de gllama*). Janjeva radhitej në vargun e pesë minierave më të njohura të Ballkanit. Si qendër e zhvilluar xehetare, ajo kishte edhe tregun e pasur me prodhime të shumta zejtare. Tregtarët shfrytëzonin kryesisht rrugët antike të karvanëve. Njëra prej rrugëve të shumta të brendshme që e lidhte Janjevën me qytetet e tjera ishte ajo që nisej nga Vranja dhe vazhdonte në Gjilan, nëpërmjet Përlepnicsës, e përfundonte në Novobërdë e Janjevë, e prej aty në Prishtinë.

Edhe pas rënies nën sundimin osman (1455), Janjeva vazhdoi të ishte një qendër e rëndësishme xehetare. Osmanët vazhduan t'i angazhonin sasët dhe raguzanët në veprimtaritë e tyre xehetare dhe tregtare. Madje Janjeva menjëherë ishte regjistruar si has i sulltanit. Si edhe minierat e tjera të Kosovës, edhe minierat e Janjevës kishin ligjin e vet (1448). Sipas burimeve osmane dhe relacioneve kishtarë katolike, nga mesi i shek. XVI Janjeva ishte qytezë (kasaba) me rreth 2,000 banorë, ndërsa gjatë shek. XVII kishte rreth 3,000 banorë, prej të cilëve afërsisht 1/3 kishin përqafuar islamin, ndërkaq pjesa tjetër ishin latinë (katolikë) dhe skizmatikë (ortodoksë). Duke qenë se prosperiteti i Janjevës ishte i lidhur ngushtë me xehetarinë, nga mesi i shek. XVII xeheroret e Janjevës, sikurse edhe xeheroret e tjera të Ballkanit, përjetuan rënie dhe pothuaj ndërprerje të plotë të shfrytëzimit të xeheve. (Gazmand Rizaj)

JANJEVA. Qytezë në komunën e Lipjanit, 12 km në verilindje të qendrës. Është vendbanim



JANJEVA

i tipit të grumbulluar, i cili shtrihet në dy anët e luginës së lumit Janjeva, në lartësi mbidetare 750 m. Sipërfaqja është 1,084 ha, nga e cila 70% janë ara, 28% pyje dhe 2% hapësirë e ndërtuar. Janjeva njihet si lokalitet i lashtë xehetar. Këtë e dëshmojnë mbishkrimet, miniera, monedhat dhe gjësendet e shumta të gjetura në këtë vend. Si vendbanim u themelua që në shek. IV. Përmendet për herë të parë në vitin 1303 në një letër të Papa Benediktit IX dërguar kryepeshkopit të Tivarit. Ishte e njohur për xehetari, zejтари, shkrirje dhe përpunim të metaleve të argjendit dhe arit. Në dokumentet e hershme njihet me emra të ndryshëm si Agnevo, Janeua etj. Deri në vitet '60 të shek. XX ishte qendër komunale, kur integrohet nën administrimin e komunës së Lipjanit. Banohej kryesisht me popullsi kroate, e cila filloi të shpërngulej me ndryshimet politike që ndodhën në ish-Jugosllavi. Edhe pse humbi rëndësinë e dikurshme si qendër xehetare dhe tregtare, shumë banorë të saj edhe në kohët e vona vazhduan të merreshin me zejtari, përpunimin e metaleve, tregti, vreshtari etj. Ka një fabrikë të metaleve, të miellit, dyqane zejtare, tregtare etj. Janjeva është sinonim i veprimtarit dhe atdhetarit të shquar Shtjefën Gjeçovit, etnograf, arkeolog dhe shkrimtar i lindur në këtë qytezë. Qyteza ka shkollën fillore, qendrën shëndetësore dhe administratën lokale. Në vitin 2011 kishte 2,137 banorë, ndaj 2,585 banorëve në vitin 1921. (Përparim Gashi)

JANJIQ (Janjić) Sava (1965-). Prift serb, igumen i manastirit të Deçanit. Lindi në Dubrovnik, ndërsa shkollën fillore e të mesme i përfundoi në Trebinje. Kreu studimet për gjuhë angleze, ndërsa karrierën në hierarkinë e kishës serbe e nisi në Manastirin “Cërna Reka” më

1989, kur ishte igumen ish-peshkopi i Rashkës dhe Prizrenit, Artemije Radosavleviqi. Në këtë manastir i kaloi disa vjet, më pas vazhdoi në Manastirin e Deçanit. Që nga viti 1994 është marrë me informatikë dhe ka arritur që kishën serbe ta afrojë me teknologjinë bashkëkohore, prandaj gazetarët e huaj i kanë vënë nofkën “cubermonk” (murg kibernetik). (Qemajl Morina)

JAPIGËT. Fis ilir. U shpërngulën në Italinë e Jugut në fillim të epokës së hekurit (rreth shek. XII p.e.r.). Fillimisht u vendosën në Gadishullin e Garganos, pastaj në Apuli (Kalabria antike) dhe përfundimisht në jug të saj, në hyrjen e ngushticës së Otrantos. Autorët antikë e përdorën emrin e japiigëve si emërtim përmbledhës për mesapët, kalabrët, salentinët, pericezët dhe daunët. Shpeshherë emri i tyre është ngatërruar me mesapet, të cilët u shpërngulën në krahinë më vonë se japiigët, por që shpejt morën epërsi mbi ta. (Premtim Alaj)

JASIQI D. Ali (1937-2014). Kritik letrar. Lindi në Jasiq të Junikut. Kreu shkollimin në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar si gazetar në të përditshmen “Rilindja”, kryeredaktor i revistës për kulturë, art e letërsi “Fjala”, kryeredaktor i revistës letrare “Jeta e re”. Ka qenë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Në fushën e letërsisë krijimtarinë e tij e filloi me poezi dhe prozë, për t’iu përkushtuar më pas kritikës letrare. Në vitin 2014 u botua kompleti i veprave të tij, në të cilin përfshihen: kritikë letrare, poezi, prozë, publicistikë. Në veprat e tij “Pesha e fjalës”(1971), “Shfletime”(1972), “Premtime e realizime”(1976), “Pesëdhjetë shkrime për poezinë”(2007), A. Jasiqi u mor me probleme të ndryshme të letërsisë shqipe, përkatësisht me vepra të autorëve bashkëkohorë. (Sali Bashota)

JASNIQ Millutin (Milutin Jasnić) (1912-1994). Aktor, regjisor. Lindi në Krlevë (Serbi). Filloi punën në Teatrin Popullor Krahinor (TPK) në Prishtinë që nga viti 1948, si aktor dhe organizator në të dy ansamblet e këtij teatri, në gjuhën shqipe dhe serbe. Në sezonin teatror 1958/59 u largua nga TPK-ja, për të punuar në Teatrin e Kragujevcit, ndërsa u kthye sërish në Prishtinë, ku punoi si aktor, regjisor dhe drejtor i dramës serbe deri në vitin 1966. Në këtë teatër

u shqua në shfaqjet: “Uji i bjeshkës”, “Zonja ministreshë”, “Të gjithë bijtë e mi”, “Ana Kristi”, “Pigmalioni” etj. Po ashtu në TPK bëri regjinë e shfaqjeve “Uji i bjeshkës”, “I ndjeri”, “Maçoku në çizme”, “Fëmija i huaj”, “Tartufi” etj. Luajti edhe në filmat “Do të jetojë ky popull” (1947), “Eshaloni i doktorit M.” (1955), “Toka e huaj” (1957), “Uka i Bjeshkëve të Nemuna” (1968), “Buka” (1973), “Ndjekja” etj. Luajti edhe në filmat francezë “Rruga e madhe e kaltër” (1957) dhe “Shtrëngata” (1958). (Besim Rexhaj)

JASTREBOV Stepanoviç Ivan (1839-1894). Diplomati rus, historian, etnograf. Në vitin 1866 filloi aktivitetin diplomatik në ambasadën ruse në Stamboll. Shërbeu në konsullatat ruse në Cetinë, Shkodër, Prizren, Janinë dhe Selanik. Në Prizren qëndroi dy herë: nga 1870-1876 dhe 1879-1886. Në periudhën 1886-1894 shërbeu si konsull i përgjithshëm në Selanik. Jastrebov mbrojti idetë sllave dhe ortodokse dhe nuk i shihte me sy të mirë lëvizjet e popujve joslavë. Mohoi karakterin kombëtar të Lidhjes së Prizrenit, të cilën e konsideronte një sajese të huaj, një instrument në dorë të Portës së Lartë. Ai e pati etiketuar atë “Komuna e Prizrenit”, për analogji me Komunën e Parisit dhe përpiquej të gjente pika të përbashkëta midis Pashko Vasës dhe gjeneralit në Komunën e Parisit, Klyzer (Clusere). Ka botuar disa libra, midis të cilëve, “Zakone dhe këngë të serbëve të turqizuar në Prizren, Pejë, Moravë dhe Dibër”. Vdiq në Selanik. (Islam Lauka)

JASHANICA Azem (Bellaqefci) (1914-1948). Lindi në Bardh të Madh në Fushë-Kosovë. Në vendlindje kreu shkollën fillore në gjuhën serbe dhe si shtatëmbëdhjetëvjeçar punësohet në hekurudhë. Si punëtor i vyeshëm e çojnë për shkollim në Nish. Më 1935/36 bëhet teknik i hekurudhave. Më 1937 dërgohet ushtar, ku pas disa muajve e burgosin për veprimtari anti-shtetërore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1942-43) kreu Shkollën e Lartë të Komunikacionit Hekurudhor dhe emërohet përgjegjës i hekurudhës në relacionin Fushë-Kosovë - Pejë. Më 1945, Kosova u nda në katër qarqe, e në qarkun e tretë, ku bënte pjesë Prishtina, A. Jashanica ishte nënkryetar. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore iu bashkua rezistencës së armatosur antikomuniste dhe antijugosllave. U përfshi në radhët e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare. Doli në ilegalitet në fillim të marsit të

vitit 1946 dhe më pas i bashkohet Ajët Gërgurit. U vra në shkurt të vitit 1948. (Liman Rushiti).

JASHANICA. Fshat në komunën e Klinës, 6 km në verilindje të saj. Shtrihet në lartësi mbidetare 450 m. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, me sipërfaqe 44.9 km². Përmendet në shumë dokumente mesjetare. Me emrin Joshanica përmendet në defterin kadastral turk (1455) të vilajetit Vëllk dhe defterin e sanxhakut të Shkodrës (1485). Numri i popullsisë është 3,223 banorë (2011). Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare etj. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë fshatrat Dush, Gjurgjevik i Madh, Pograxhë, Jelloc dhe Resnik. (Ferim Gashi)

JASHARI Adem (1955-1998). Themelues i UÇK-së, luftëtar dhe komandant i saj, Hero i Kosovës. Lindi në Prekaz të Drenicës. Kreu shkollën e mesme teknike në Skënderaj. Në vitet



ADEM JASHARI

1981-1989 mori pjesë në aktivitete të ndryshme kundër pushtetit. Më vonë u bë anëtar i Lëvizjes për Republikën e Kosovës. Në vitin 1990 organizoi grupet e para të armatosura në Drenicë. Në vitin 1991 shkoi në Shqipëri, bashkë me një grup luftëtarësh, ku u stërvit nga ushtarakë të atjeshëm. Grupi në fillim të dhjetorit u kthye i armatosur në Kosovë. Në mëngjesin e 30 dhjetorit 1991 policia serbe ndërmori aksion për kapjen e grupit, me çrast u rrethua shtëpia e A. Jasharit në fshatin Prekazi i Poshtëm, ku ai jetonte së bashku me familjen e gjerë. Sulmi nuk dha rezultat, kështu që forcat serbe u detyruan të tërhiqen. Pas këtij aksioni, A. Jashari dhe formacioni i tij veproni në Prekaz dhe fshatrat përreth Skënderajt e Drenasit. Këto aksione guerile vazhduan për shtatë vjet. Aksionet e armatosura të formacionit të A. Jasharit të kryera në Drenas në vitet 1992/93 çuan drejt përshpejtimit të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në prill të vitit 1993 në shtëpinë e A. Jasharit u mbajt një takim i pjesëtarëve të formacionit të tij të armatosur, ku morën pjesë edhe veprimtarë politikë. Me propozimin e A. Jasharit u vendos që aksionet e armatosura në të ardhmen të bëhen në emër të

Ushtrisë së Kosovës, ndërsa komandant i saj u emërua A. Jashari. Më 25 nëntor 1997 luftëtarët e Adem Jasharit sulmuan trupat e policisë serbe në Vojnik, duke i detyruar të tërhiqen. Të nesërmen, një ekspeditë ndëshkimore serbe, me mjete të motorizuara, u drejtuan për në Vojnik. Adem Jashari me dhjetë luftëtarë u zuri pritë në Rezallë të Re dhe, pas katër orë luftimesh, forcat e policisë serbe u tërhoqën. Në tërheqje e sipër, forcat serbe, të egërsuara për disfatën, bënë reprezalje mbi banorë të paarmatosur në fshatin Llaushë, ku vranë mësuesin Halit Geci në derë të shkollës. Në ceremoninë e varrimit, që u zhvillua më 28 nëntor 1997, me urdhër të A. Jasharit dolën në tribunë për herë të parë përfaqësuesit e UÇK-së. Po në këtë vit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, A. Jasharin e dënoi në mungesë me 20 vjet burg. Pas këtyre zhvillimeve, forcat policore nuk mundën të hynin në Drenicë deri më 22 janar 1998, ditën kur me një sulm diversant policia serbe sulmoi Jasharajt në shtëpinë e tyre. Atë natë A. Jashari nuk ndodhej në shtëpi. Luftuan i ati, Shabani, i vëllai, Hamëza dhe anëtarë të tjerë të familjes. Gjatë këtij sulmi nga Jasharajt u plagosën Ilirianë e Selvete Jashari. Forcat serbe u detyruan të tërhiqen. Më 28 shkurt 1998, një njësit i UÇK-së ra në pritë në Likoshan, por njësit korri fitore, duke vrarë gjashtë policë serbë dhe duke plagosur disa të tjerë. Pas kësaj disfate forca të shumta policore dhe ushtarake serbe sulmuan me tanke e helikopterë Likoshanin dhe Qirezin. Në shenjë hakmarrjeje vranë 24 civilë. A. Jashari me disa luftëtarë depërtuan përmes rrethimit dhe tërhoqën të plagosurit dhe ata që kishin mbetur brenda rrethimit. Sulmi i tretë i forcave serbe mbi familjen e A. Jasharit u bë më 5 mars 1998. Kësaj radhe forcat serbe shoqëroheshin me tanke, autoblanda dhe artileri të rëndë. Ato rrethuan Prekazin në tre skalione. Në mëngjesin e 5 marsit 1998, në orën 5 e 30 filloi sulmi i koordinuar nga kodrat e Skënderajt, Lisat e Xanëve dhe Fabrika e Municionit, e cila gjendej në afërsi të Lagjes së Jasharajve dhe që prej kohësh ishte kthyer në garnizon ushtarak. Atë ditë nga 30 anëtarët e familjes Jashari, në shtëpi ndodheshin 22 sish. Të udhëhequr nga A. Jashari, të gjithë pjesëtarët e familjes Jashari luftuan tri ditë dhe tri net, derisa u vranë që të gjithë (20 veta nga mosha 9-të deri 74 vjet) me përjashtim të Besartës, vajzës së vogël të Hamëz Jasharit, e cila u fsheh në gjirin e nënës së

vdekur. Nga ai rrethim shpëtoi edhe Bashkim Jashari, i cili arriti ta çante rrethimin. Bashkë me familjen Jashari u vra edhe Osman Geci nga Llausha. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, më 25 janar 1999 A. Jashari u shpall komandant i saj legjendar. Luftimet treditore në Prekazin e Poshtëm, rënia e A. Jasharit dhe e 58 pjesëtarëve të familjes Jashari u bënë frymëzim për të gjithë luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. (Jakup Krasniqi)

JASHARI Artim (1974-1998). Aktivist i organizatave studentore, pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Mitrovicë. Pasi kreu shkollën e mesme, filloi studimet për gjuhë dhe letërsi angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ishte pjesëmarrës i demonstratave në Mitrovicë (20 janar 1990). Më 1993 emigroi në Suedi, ku qëndroi deri në vitin 1995. Pas kthimit në Kosovë u përfshi në zhvillimet politike të kohës. Ishte kryetar i Rinisë Republikane Shqiptare (RRSH). Për shkak të aktivitetit politik në shtator të vitit 1997 u arrestua nga policia serbe. Me fillimin e luftës së armatosur u inkuadrua në radhët e UÇK-së. Më 5 maj 1998 në qytetin e Mitrovicës zhvilloi një aksion të armatosur kundër policisë serbe. Gjatë këtij sulmi u plagos rëndë dhe më pas vdiq nga plagët e marra. (Sabit Syla)

JASHARI Baki (1960-). Kompozitor, diri-gjent. Lindi në Prishtinë, ku kreu dhe shkollimin e mesëm muzikor. Studimet në degën e kompozimit i përfundoi në Fakultetin e Muzikës në Lubjanë (1980-84) te prof. D. Shkerl. Në të njëjtën kohë ndoqi dhe studimet e muzikologjisë në Fakultetin Filozofik në Lubjanë deri në vitin 1985. Pas diplomimit u kthye në Prishtinë, ku për tri vjet dirigjoi korin e Radio Prishtinës (1987-1990), pastaj u kthye sërish në Lubjanë dhe vazhdoi aktivitetin muzikor si pedagog i teorisë së muzikës dhe drejtues i orkestrës së harqeve në shkollën e ulët të muzikës. Pas rikthimit në Prishtinë (2000) vazhdoi si pedagog i analizës harmonike në degën e muzikës të Fakultetit të Arteve. Një kohë ishte producent i muzikës në Radiotelevizionin e Prishtinës. Ka një opus



BAKI JASHARI

veprash korale (“Agimi”, kor i përzier, 1979, “Dimni”, kor i femrave 1979, “Nji lule”, kor i përzier, 1983, “Pakëz në ëndërr, pakëz në zhgëndërr”, kor i përzier me recitues, 1986), pastaj një sërë veprash kamerale (Këngë për obo e flaut, 1979, Lutje, për mezosoprano e piano, 1979, pjesë për kornë e trio harqesh, 1979, Miniaturë për violonçel e piano, 1997) dhe veprash orkestrale (Passacaglia për orkestër harqesh, 1980 dhe Sinfonietta in due tempi, 1984). Si dirigjent e kompozitor është shpërblyer në Slloveni, medalja e argjendtë me korin e femrave “Sloga” (1981) dhe “Grand Prix” në garat e orkestrave frymore në Hungari (1998). Nga viti 2007 është drejtor i Korit dhe Orkestrës së Filarmonisë së Kosovës. (Rreze Kryeziu-Breznica)

JASHARI Behlul (1953-). Gazetar. Lindi në Strofc të Vushtrrisë. Kreu shkollën normale në Prishtinë dhe studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe. Nga viti 1973 punoi në gazetën “Rilindja” si gazetar, reporter i lirë, redaktor dhe kryeredaktor i gazetës së përditshme “Bujku”, pas mbylljes së “Rilindjes” më 1990. Nga viti 1992 ishte edhe korrespondent nga Kosova i Agjencisë Telegrafike Shqiptare dhe raportoi për Radiotelevizionin Shqiptar para dhe gjatë luftës në Kosovë. Në vitin 2002 u zgjodh kryeredaktor i gazetës “Rilindja”, më pas kryetar i këshillit drejtues, kur punonjësit e “Rilindjes” u nxorën nga Pallati i Shtypit nga administrata e UNMIK-ut. Ishte kryeredaktor i gazetës deri më 30 dhjetor 2008, kur u përmbyll seria e numrave të jashtëzakonshëm protestues. Bashkëpunoi me gazeta e revista të vendit. Botoi librin me poezi “Ecim hah një mrekuulli” (1973), pastaj monografinë “Rilindja, 60 vjet” etj. (Ibrahim Berisha)

JASHARI Gani (1952-). Fizikan, profesor universitar. Lindi në Medvegjë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën Normale në Prishtinë (1972). Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP) në vitin 1976. Studimet pasuniversitare i kreu në UP (1982), ndërsa tezën e disertacionit nga fusha e fizikës atomike e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1984). Është autor i tekstit universitar “Fizika atomike dhe molekulare” dhe i disa teksteve për fizikë për nxënësit e shkollave të mesme. Botoi punime shkencore në revista ndërkombëtare e

vendore dhe mori pjesë me kumtesa në tubime shkencore në botën e jashtme dhe në Kosovë. Ka ushtruar funksione politike dhe partiake në periudhën e autonomisë së Kosovës dhe ka kryer detyra në institucionet e vendit edhe pas vitit 1999. (Rexhep Gashi)

JASHARI Hamëz (Shaban) (1950-1998). Luftëtar dhe udhëheqës i UÇK-së, vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, Hero i Kosovës. Lindi në Prekaz të Poshtëm të Drenicës. Ishte



HAMËZ JASHARI

djali i dytë i Shaban Jasharit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Skënderaj, Shkollën e Lartë Ekonomike në Prishtinë. Punoi në Fabrikën e Municionit në Skënderaj. Që në fillim të vitit 1991 la punën dhe u bashkua me vëllanë, Ademin, duke iu përkushtuar luftës për çlirim të Kosovës. Që nga sulmi i parë i policisë serbe në familjen Jashari, ai ishte gjithnjë në krye të çdo aksioni. Me Ademin ishte në Vojnik e Rezallë të Re, ishin bashkë në mbrojtje të njësitit të UÇK-së që u gjet i rrethuar në Qirez e Likoshan. Ndodhej pa Ademin në sulmin e 22 janarit 1998, kur me të atin iu përgjigjën sulmit të diversantëve serbë. Ishte së bashku me Ademin në luftimet e zhvilluara më 5, 6 e 7 mars 1998. Në këto luftime u vra edhe bashkëshortja e tij, Feride Jashari (Mecini) me shtatë fëmijë. Për heroizmin dhe sakrificën e pashembullt u nderua me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Jakup Krasniqi)

JASHARI Ismet (1967-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant “Kumanova”, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Orizare të Kumanovës. Shkollën e mesme e



ISMET JASHARI

nisi në Kumanovë dhe e përfundoi në gjimnazin e Preshevës. Atë kohë u inkuadrua në radhët ilegale të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Në gusht të vitit 1988 emigroi në Zvicër, ku e vazhdoi veprimtarinë atdhetare. Pas Epopesë së Prekazit, në mars të vitit 1998, iu bashkua radhëve të UÇK-së. Fillimisht u

vendosën në Shtabin e UÇK-së në Likoc të Drenicës, më pas u caktua me detyrë ushtarake në Zonën e Llapushës. Në radhët e UÇK-së u bë i njohur si “Kumanova”. Në mars të vitit 1998, së bashku me F. Limajn, H. Shalën, S. Shalën e të tjerë formojnë njësitin ushtarak “Çeliku”, me bazë në Kleçkë. Në maj të vitit 1998 mori pjesë në betejat rreth grykës së Llapushnikut, ndërsa më 17 qershor, me bashkëluftëtarët e tij ndërmori një sulm kundër forcave serbe, të cilat po tentonin të depërtonin në drejtim të Luzhnicës. Luftoi në mbrojtjen e pozicioneve të UÇK-së gjatë ofensivës serbe të 25 dhe 26 korrikut 1998, në grykë të Llapushnikut dhe në fshatin Zborc, afër grykës së Carralevës. Më 23 gusht 1998 kur ushtria serbe ndërmori sulmin në drejtim të Kleçkës, ku ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, organizoi rezistencën në Bajrak të Luzhnicës. Në mëngjesin e hershëm të 25 gushtit ndërmori një kundërsulm në përpjekje për t'i tërhequr trupat e ushtarëve të rënë. Pas disa orë luftimesh, në Luzhnicë I. Jashari ra dëshmor. Në nderim të tij, Brigada 121 e Zonës Operative të Pashtrikut të UÇK-së mori emrin “Ismet Jashari-Kumanova”. Në Prizren, afër Shtëpisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është ngritur shtatorja e tij. Më 2009 presidenti i Republikës së Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Fetnete Ramosaj)

JASHARI Kaqusha (1946-). Funkionare e lartë partiake gjatë periudhës së autonomisë, kryetare e Partisë Socialdemokrate të Kosovës, deputete, inxhinieri. Lindi në Prishtinë. Shkol-



KAQUSHA JASHARI

limin fillor dhe të mesëm e vijoi në Kamenicë, Gjilan dhe Prishtinë. Fakultetin e Ndërtimtarisë e filloi në Beograd dhe e përfundoi në Prishtinë. Punoi në operativën ndërtimore në Ferizaj deri më 1975. Në periudhën 1975-1988 ushtroi funksione me rëndësi në organet krahinore të periudhës së autonomisë, ndër të cilat edhe kryetare e Bashkimit të Sindikatave të Kosovës (1986) dhe kryetare e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. (1988). Po në këtë kohë, pas përfshirjes në konfliktet politike që shpërthyen ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, u largua nga funksioni dhe deri më 1990 ushtroi detyrën e drejtorit të

autoritetit rrugor të Kosovës. Në vitet '90 vazhdoi aktivitetin politik në radhët e Partisë Socialdemokrate të Kosovës (PSDK) dhe në periudhën 1998-2008 ishte kryetare e kësaj partie. Në legjislaturën e dytë (2006-2010) ishte deputete e Kuvendit të Kosovës. Merret edhe me pikturë dhe ka hapur disa ekspozita personale. (Daut Bislimi)

JASHARI Mehdi (1944-). Hendbollist, trajner, profesor universitar. Lindi në Ferizaj, studimet themelore i kreu në Fakultetin e Kulturës Fizike në Sarajevë. Studimet e magjistraturës



MEHDI JASHARI

i përfundoi në Fakultetin e Kulturës Fizike në Novi-Sad (1985), kurse studimet e doktoratës në Institutin e Kulturës Fizike “Vojo Kushi” në Tiranë (1995). Për pesëmbëdhjetë vjet ishte aktiv në hendboll, në ligat e ndryshme të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë, në klubin e hendbollit “Obiliqi” dhe “Borci” të Ferizajt. Ishte trajner i ekipeve të hendbollit për femra dhe për meshkuj të klubit të hendbollit “Borci” dhe “Prishtina”. Shumë vjet ishte kryetar i Federatës së Notit të Kosovës. Ishte ligjiërues në Shkollën e Trajnerëve të Hendbollit, ndërsa në bashkautorësi botoi librin “Rregullat ndërkombëtare të hendbollit” dhe tekstin universitar “Hendbolli”. (Albatrit Matoshi)

JASHARI Musa (1970-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Prekaz të Poshtëm, komuna e Skënderaj. Që në fillim të viteve '90 mori pjesë në organizimin e grupeve të para të luftës çlirimtare në Kosovë. Më 30 dhjetori 1991 mori pjesë në luftime, pas sulmit të parë të forcave serbe ndaj familjes Jashari. Gjatë viteve 1996-97 organizoi grupet vullnetare për të shkuar për armatim në Shqipëri. Ishte pjesëmarrës i një sërë aksionesh të armatosura. Më 31 dhjetor 1997 u plagos nga forcat serbe afër Fabrikës së Municionit në Prekaz. Më 22 janar 1998 mori pjesë në luftime, pas sulmit serb në familjen Jashari. Ishte një ndër luftëtarët kryesorë në betejën e Likoshanit dhe Qirezit më 28 shkurt 1998, ku u plagos sërisht. Pas shërimit nga plagët, formoi njësitet luftarake “Guri 1”, “Guri 2”, “Guri 3” etj. Në qershor të vitit 1998 u emërua komandant

i Zonës Operative të Pashtrikut. Më 15 dhjetor 1998 u emërua shef i komunikimit në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe në maj të vitit 1999 u emërua edhe zëvendëskomandant i Operacionit “Shigjeta”. Pas luftës dhe demilitarizimit të UÇK-së, kaloi në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. (Sabit Sylja)

JASHARI Nafi (1957-). Grafist. Lindi në Negotinë të Gostivarit. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Novi-Sad, ndërsa studimet në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, degën e grafikës. Në fillim punoi si mësimdhënës në disa shkolla fillore dhe të mesme, ndërsa më vonë si pedagog në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Është anëtar i Shoqatës “Draudakum” në Gostivar dhe anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Maqedonisë. Në veprimtarinë e tij grafike bën sintezë ndërmjet disiplinave klasike dhe atyre bashkëkohore. Ekspozitat personale i realizoi në Shkup, Nju-Jork, Prishtinë, Tetovë e Gostivar. (Jëldeze Asani)

JASHARI Ramadan (1954-). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe i zemrës, drejtor mjekësor në Bankën Europiane të Homografit në Bruksel. Lindi në Doganaj të Ferizajt, studimet



RAMADAN JASHARI

dhe specializimin nga kirurgjia i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Gjatë viteve 1981- 1990 ishte mjek në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë dhe në periudhën 1985-1990 asistent në lëndën e kirurgjisë. Qëndroi një vit për përsosje profesionale në Tokio (1988) dhe më pas specializoi kardiokirurgjinë në disa qendra mjekësore të Belgjikës. Më 2001 kaloi provimin para Bordit European të kardiokirurgëve. Është kirurg i zemrës në Klinikën “St. Jean” në Bruksel dhe nga viti 2008 drejtoi Bankën Europiane të homografëve kardiovaskularë. Ishte anëtar i bordit të Shoqatës së Kardiokirurgëve të Belgjikës, i bordit të Asociacionit European të Bankave të indeve (EATB) dhe kryetar i Komiteti European për Terapi të Avancuar, i Komitetit European për Transplantim të Organeve (CD-P-TO) dhe nga viti 2012 anëtar i bordit redaktues të revistës “Cell and Tissue Banking”. Ishte pjesëmarrës në

disa projekte si ekspert në lëmin e transplantimit të indeve dhe të organeve (Euro-GTP, ESPOIR, DoHeCa) në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe në ECDC (Qendrën Europiane për Kontrollin e Sëmundjeve). Ka bërë mbi 100 prezantime dhe mbi 35 publikime shkencore dhe profesionale dhe është bashkëpunëtor i disa revistave botërore në lëmin e transplantimeve, ligjërues në disa kurse ndërkombëtare për transplantimin e organeve, të indeve dhe të qelizave dhe anëtar i këshillave shkencore për një sërë kongresesh ndërkombëtare. Jeton në Bruksel. (Avdyl Krasniqi)

JASHARI Rifat (Shaban) (1946-). Vëllai i Adem Jasharit, djali i madh i Shaban Jasharit nga Prekazi i Poshtëm. Që i ri mori rrugën e kurbetit dhe nga viti 1969 punoi në Gjermani. Prej atëherë ai ishte shtylla kryesore e familjes, për mëkëmbjen e saj ekonomike. Ai krijoi mundësi për shkollimin e djemve dhe nipave të tij. Në dhjetorin e vitit 1991 u gjend pranë familjes dhe më 30 dhjetor mori pjesë në aksionin luftarak bashkë me të vëllanë, Ademin. Pas këtij aksioni, ai disa ditë u strehua në disa familje në Abri e Negroc, në Prizren dhe më pas ilegalisht kaloi në Shqipëri, prej nga vazhdoi rrugën për në Gjermani. Gjatë këtyre viteve i bashkohen në mërgim djali i tij i madh, Murati dhe nipat: Luli i Ademit dhe Bekimi i Hamzës. Ngjarjet e vitit 1998 e gjetën larg familjes, në Gjermani. Pas luftës në Prekaz, duke mbajtur gjithmonë hapur derën e shtëpisë së Jasharëve për mysafirët dhe vizitorët e shumtë. (Jakup Krasniqi)

JASHARI Ruzhdi (1955-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), gazetar. Lindi në Jezerc të Ferizajt. Kreu shkollën e mesme në Ferizaj, studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1982). Kreu studimet edhe për gazetari. Në periudhën 1982-1989 punoi në Shkollën Teknikë dhe në Fabrikën e Gypave në Ferizaj, më pas në shkollën e mesme “Naim Frashëri” në Shtime. Në pranverë të vitit 1998 iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Nerodimes (ZON). Gjatë luftës raportoi për Televizionin Shqiptar nga zonat e luftës. Më 1999, nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u caktua zëdhënës për ZON. Më 15-19 janar 1999 raportoi për krimin e ushtrisë dhe policisë serbe në Reçak. Pas luftës u përfshi

në organizimin politik të Partisë Demokratike të Kosovës në Shtime. Ka botuar disa libra: “Zëri i lirisë” (2009) “Dosje e dokumenteve dhe dëshmi sekrete serbe” (2013), si dhe është bashkautor i librit “Masakra e Reçakut - krim kundër njerëzimit” (2004) etj. (Ali Uka)

JASHARI Sahit (1965-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Prekaz të Ulët. Bënte pjesë në grupet dhe celulat e para të luftës çlirimtare në Kosovë. Nga viti 1991 bënte pjesë në grupin e armatosur të Adem Jasharit. Mori pjesë në luftimet kundër forcave serbe më 30 dhjetor 1991, gjatë rrethimit të parë të familjes Jashari. Më pas, në periudhën 1992-1996 ndërmori një sërë aksionesh kundër stacioneve policore serbe në Runik, Mitrovicë dhe lokalitete të tjera të Kosovës, ndërsa më 30 dhjetor 1996 u plagos në Prekaz. Për shkak të angazhimit të tij, Gjykata serbe në Prishtinë në korrik të vitit 1997 e dënoi në mungesë me 20 vjet burg. I plagosur sërish në korrik të vitit 1997, vazhdoi shërimin në Shqipëri dhe më pas në Suedi. U kthye në Kosovë në mars 1998. Pas formimit të brigadave 113, 114 dhe 112 të UÇK-së u emërua nga Shtabi i Përgjithshëm në pozitën e komandantit të Policisë Ushtrake për Zonën Operative të Drenicës. Mori pjesë në një sërë betejash edhe jashtë Zonës Operative të Drenicës, si në Malishevë, Rahovec etj. Pas përfundimit të luftës u angazhua në Policinë e Kosovës dhe në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. (Sabit Sylja)

JASHARI Shaban (Murat) (1924-1998). Luftëtar për çlirimin e Kosovës, dëshmor. Ishte i ati i Adem Jasharit. Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm. Kishte të kryer medresenë dhe pas Luftës së Dytë Botërore vazhdoi shkollimin për mësues. Profesionin e mësuesit e ushtroi nga viti 1949 deri në vitin 1952. Në vitin 1952 u burgos. Me urdhër të pushtetit, për më shumë se gjashtë vjet ishte i lëçitur nga të afërmit dhe miqtë e tij. Pas burgut vazhdoi të merrej me bujqësi. Në vitin 1981, së bashku me të bijtë Hamzën dhe Ademin organizuan varrimin e Tahir e Nebih Mehajt. Pas sulmit të policisë serbe në familjen Jashari më 30 dhjetor 1991, u burgos nga shteti serb, por në mungesë provash u lirua. Në sulmin e 22 janarit 1998 ishte përkrah djemve dhe nipave të vet, për t’u kundërvënë forcave serbe. Njësoj bëri edhe më 5, 6 dhe 7 mars 1998, kur u vra në luftë

për të mbrojtur pragun e shtëpisë dhe lirinë e Kosovës. (Jakup Krasniqi)

JASHARI Xhevdet (1978-). Aktor. Lindi në Negotinë të Gostivarit, ku kreu shkollën fillore, shkollën e mesme në Gostivar, kurse studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve në Shkup. Deri tani luajti një sërë rolesh në teatër dhe në film. Rolet më të rëndësishme i realizoi në shfaqjet: “Peer Gynt” me regji të S. Unkovskit, “Dervishi dhe vdekja” me regji të V. Milçinit, “Jetë me qira” me regji të L. Cortina, “Opera e lypsarëve” me regji të D. Mustafiq, “Paraja” me regji të I. Bokshi, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” me regji të D. Mustafiq, “Heshtje” me regji të A. Kallabas, “Rebelët” me regjia të B. Lumes, “Akuariumi” me regji të L. Cortina etj. Ka luajtur edhe në filmat: “Koha e kometës” të F. Koçit, “Unë jam nga Titov Velesi” dhe “E kam vrarë një shenj” të T. Mitevskës, “Panku nuk është i vetëm” të V. Blazhevskit, “Babai” të V. Morinës, “Agon” të R. Budinës, në serialin turk “Elveda Rumeli” dhe në serialin televiziv “O sa mirë”. Xh. Jashari konsiderohet si aktor ekspresiv që arrin të mishërohet thellësisht me karakterin e personazhit. (Salajdin Salihu)

JASHAR-NASTEVA Olivera (1922-2000). Gjuhëtare, ballkaniste, maqedoniste, leksikologe. Lindi në Beograd. Ishte anëtare e rregullt e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të



OLIVERA
JASHAR-NASTEVA

Maqedonisë (ASHAM). Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Shkup. Është e bija Emin Beut të Shkupit, pjesëmarrës i Kongresit të Manastirit me të drejtë vote, si përfaqësues i Klubit të Shkupit, dhe mbesë e Jashar Beut, hartues i programit të Lidhjes së Prizrenit. U diplomua në Fakultetin e Filozofisë në Shkup (1949), ndërsa u doktorua më 1962 me temën mbi elementet leksikore turke në maqedonishten. Ishte njëra nga nismëtalet e themelimit të katedrave të gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe gjuhës turke dhe letërsisë në Shkup dhe për një kohë i udhëhoqi këto katedra në Universitetin e Shkupit. Ligjëroi lëndët gjuhë shqipe dhe gjuhë turke. Në vitin 1983 bëhet anëtare e ASHAM-it, ndërsa më herët anëtare e Akademisë së Shkencave të Turqisë (1979). Trajtoi

tema nga interferencat gjuhësore, gjuhët në kontakt, lidhjet gjuhësore etj. Botoi studime dhe mbajti kumtesa dhe referate nëpër shumë simpoziume e kongrese. Mbajti ligjërata në Napoli, Paris, Krakov, Moskë, Ankara, Çikago etj. Ndihmesë të madhe ka dhënë në fushën e morfologjisë dhe leksikologjisë të gjuhëve ballkanike. (Berton Sulejmani)

JENSEN Skafta Minna (1937-). Studiuese e epikës gojore shqiptare në Danimarkë, homerologe, profesore. Qëndroi në Shqipëri më 1974 dhe studioi te prof. Androkli Kostallari. Gjatë qëndrimit në Shqipëri ka punuar edhe në fushën e hulumtimit e të studimit të traditës epike gojore në *Shqipërinë e Veriut*. Ka marrë pjesë me kumtesa në dy konferenca shkencore ndërkombëtare për eposin e kreshnikëve në Tiranë (1983) dhe në Prishtinë (2014). Është njohëse e Homerit dhe studiuese e teorisë formulaike dhe ligjëruese në shumë vende në Europë, Amerikë dhe Azi. Është autore e një sërë botimesh për Homerin dhe veprat e tij, ndërsa më 1988 botoi veprën biografike për Marin Barletin: “Marinus Barletius ‘Skanderbeg’”. Ka qenë kryetare e Shoqatës së Miqësisë Danimarkë-Shqipëri. Është anëtare e tri akademive të shkencave: në Danimarkë, në Norvegji dhe në Belgjikë. (Zymer U. Neziri)

JELAVIÇ (Jelavich) Barbara (1923-1995). Studiuese dhe historiane amerikane. Lindi në Belleville, Illinois (SHBA). U diplomua për histori në Universitetin e Kalifornisë në Berkeley (1943) dhe mori gradën doktor në vitin 1948. Që nga viti 1961 e der sa doli në pension (1992) ajo e zhvilloi veprimtarinë akademike dhe pedagogjike në departamentin e historisë në Universitetin Indiana (SHBA). Është autore dhe bashkautore e një sërë monografish. Vepra e saj më e rëndësishme konsiderohet “Historia e Ballkanit” (1983), në dy vëllime, e ribotuar disa herë. Monografi të tjera janë: “Perandoria Habsburgase në çështjet europiane 1814-1918” (The Habsburg Empire in European Affairs) (1969); “Perandoria Osmane, Fuqitë e Mëdha dhe çështja e ngushticave, 1870-1887” (The Ottoman Empire, the Great Powers and the Straits Question, 1973); “Themelimi i shteteve kombëtare në Ballkan, 1904-1920” (The Establishment of the Balkan National States, 1804-1920; 1977), “Pengesat e Ruisë në Ballkan 1806-1914” (Russia’s Balkan Entanglements,

1806-1914) (1991) etj. Në studimet e B. Jelavich vend qendror zë historia e shteteve kombëtare në Ballkan, e në këtë kuadër analizohet edhe ecuria e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, krijimi dhe konsolidimi i shtetit shqiptar (1912-1939), vendosja e regjimit komunist dhe krahasimi i tij me vendet e tjera në Ballkan, trajtimi i shqiptarëve në Jugosllavi etj. (Ledia Dushku)

JESHEREN Rifat Agim (1951-). Shkrimtar i letërsisë turke në Kosovë. Lindi në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, Fakultetin Juridik në Prishtinë. Pas përfundimit të studimeve filloi bashkëpunimin me gazetën “Tan”. Përveç poezive dhe tregimeve shkroi dhe pjesë humoristike. Librat e tij: “Edhe 34 rubai” (1979) “Më bukur” (1981), “Poezi të vogla” (1985), “U bezdisa nga poezia” (1988), “Ujë i veçantë” (tregime, 1991). Drama “Minus-plus” (1982) u luajt nga Teatrin Amator Turk i Prizrenit. Në vitin 2000 formoi Teatrin “Jesheren Kabare” ndërsa më 2002 Shtëpinë Botuese “Nënshkrimi” (Imza). Nga viti 2012 nxjerr revistën “Kosova Imza”. (Irfan Morina)

JEVRIQ (Jevrić) Darinka (1947-2007). Poete e letërsisë serbe nga Kosova, gazetare. Lindi në Glogjan të komunës së Deçanit. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në Pejë. Kreu studimet për letërsi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Nga viti 1975 dhe deri më 1999 ishte gazetare e kulturës dhe e gazetës “Jedinstvo” në Prishtinë. Ishte redaktore për poezi në revistën letrare “Stremljenja”. Poezitë e saj u përkthyen edhe në gjuhën shqipe (“Të dhënat e pavërteta”, 1980). Botoi një sërë librash me poezi: “Prekja e verës” (1970), “Të mashtruar nga qetësia” (1973), “Shënimet e rreme” (1976), “Letër dashurie” (1990), “Puthja e Judës” (1998), “Kambanat e Deçanit dhe poezi të tjera” (2004) etj. Për veprën e saj letrare u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Ismet Markoviq)

JEVTOVIQ (Jevtović) Milenko (1935-2014). Shkrimtar i letërsisë serbe nga Kosova, gazetar. Lindi në Kolashin të Ibrit. Mbaroi shkollimin fillor në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë, studimet për letërsi jugosllave në Beograd, ku më pas kreu dhe studimet pasuniversitare dhe doktoraturën. Ishte gazetar dhe redaktor në Radio-Prishtinë, pastaj kryeredaktor i gazetës “Jedinstvo” dhe drejtor i Institutit të Gjuhës dhe Kulturës së Serbëve, Kroatëve dhe Myslimanëve

në Kosovë që nga formimi i tij. Botoi tri vepra me tregime: “Mjegullia” (1972), “Ndonjë verë tjetër” (1976) dhe “Babai dimëror” (1987). Disa tregime të tij u përkthyen në gjuhën shqipe dhe turke. Botoi edhe studime letrare. Vdiq në Kragujevc. (Ismet Markoviq)

JEZUITËT. Pjesëtarë të urdhrit të murgjve të kishës katolike, i themeluar nga ushtaraku spanjoll Ignac Loyola (1491-1556), i cili pasi u plagos rëndë, iu përkushtua fesë. Gjatë qëndrimit të tij në Universitetin e Parisit, Loyola formoi të ashtuquajturën “Shoqëria e Jezusit”, prej nga mori edhe emrin urdhri jezuit. Qëllimi kryesor i jezuitëve ishte luftimi i pakompromis kundër çdo ideje, lëvizje apo aksioni, që cenonte autoritetin e kishës katolike. Fillimi i pranisë së jezuitëve në tokën shqiptare i përket vitit 1841, me disa murgj që erdhën nga Sicilia e Italisë. Në vitin 1854, me vendim të Zyrës Misionare të Vatikanit dhe të ipeshkvijve shqiptarë, u hap në Shkodër Seminari për krejt rajonin e Ballkanit Jugor dhe iu besua etërve jezuitë italianë. Në vitin 1877 u themelua Kolegji Saverian, në fillim si shkollë tregtie dhe më pas si gjimnaz klasik, pas shpalljes së Shqipërisë në vitin 1912. Nga veprimtaria kulturore dallohen me botimin e periodikëve “Lajmëtari i Zemrës së Krishtit” nga viti 1891, “Kalendari i Veprës Pijore” nga viti 1912, të revistës “Leka” nga viti 1929 etj. Pas një largimi të gjatë, në vitin 1990 jezuitët u kthyen sërish në Shqipëri. Në shkurt të vitit 1992 u hap në Argjipeshkvinë e Shkodrës “paraseminar” për përgatitjen e meshtarëve të rinj.

Veprat e jezuitëve kanë lënë më shumë gjurmë nëpër vende rurale, ku kanë qenë “misionet shëtitëse” (Missione Volante). Të tilla misione ka pasur edhe në disa vise të Kosovës, siç ishte Famullia e Letnicës. Veprimtaria e jezuitëve në Kosovë u shtua gjatë luftës në Kosovë (1997-1999), kur u angazhuar përmes “Jesuit Refugee Service” (JRS), për të lehtësuar vuajtjet e refugjatëve, të cilët u detyruan të lënë shtëpitë e tyre. Urdhri i jezuitëve është i ndarë në 91 provinca, që gjithmonë udhëhiqen nga një provincial-epor i lartë. Kosova bën pjesë në provincën kroate, kurse Shqipëria në atë italiane të Shoqërisë së Jezusit. Jezuitët sot janë të pranishëm në Shqipëri nëpërmjet Seminarit ndërdioqezan dhe gjimnazit klasik “Pjetër Meshkalla” në Shkodër, në të cilin është

përgatitur edhe një pjesë e klerit katolik të Kosovës, kurse në Kosovë nëpërmjet gjimnazit klasik “Loyola”, që ndodhet në periferi të Prizrenit. (Gjon Berisha)

JIREÇEK (Jireček) Konstandin Jozef (1854-1918). Historian, politikan, diplomat çek, ndër studiuesit më objektivë të mesjetës së Ballkanit. Lindi në Vjenë. U doktorua në Universitetin e



JOZEF JIREÇEK

Pragës (1877). Më pas ishte docent në katedrën e gjeografisë dhe të historisë në këtë universitet. Kreu disa detyra në qeverinë bullgare (1879-1884), sidomos në Ministrinë e Arsimit (1881-1884). Ligjëroi historinë në Universitetin e Vjenës (1884-1893) filologjinë dhe lashtësinë sllave (1893-1918). Është autor i disa veprave të historisë së sllavëve të jugut: “Historia e popullit bullgar”, “Historia e serbëve”, “Shteti dhe shoqëria në Serbinë mesjetare”, “Elementi i krishterë në nomenklaturën topografike të vendeve të Ballkanit” dhe shumë studime të tjera të botuara në revista shkencore. Bashkëpunoi me L. Taloçin dhe M. Shuflajin në përgatitjen e përmbledhjes së dokumenteve “Akte dhe diploma që ilustronë çështjen e Arbërisë mesjetare” (Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia I, II) botuar në Vjenë 1913/18 etj. K. Jireçeku i qëndroi besnik tezës se në mesjetë shqiptarët shtriheshin brenda katërkëndëshit Vlorë-Ohër-Prizren-Tivar. Vdiq në Vjenë. (Ramiz Abdyli)

JOHALAS Tito (Titos Jochalas) (1942-). Gjuhëtar arvanit. Ka mësuar në gjimnazin e Janinës, studioi për filologji klasike në Universitetin e Athinës (1965), ndërsa studimet post-



TITO JOHALAS

diplomike i përfundoi në Palermo. Doktoroi në Munih më 1968. Më 1971 fillon të punojë si hulumtues në Akademinë e Athinës, ku nga viti 1982 drejton një departament. Më 1975 u emërua drejtor i Asociacionit Ndërkombëtar të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE) të Greqisë. Ka qenë anëtar i komitetit

grek në Konferencën e OKB-së për standardizimin e emrave gjeografikë në Nju-Jork më 1992. Është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 2012. Botoi artikuj që trajtojnë çështje të albanistikës dhe të albanologjisë, një monografi për Skënderbeun (1975), fjalorin e Marko Boçarit, (Το Ελληνο-Αλβανικών Λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη”, 1980) si kontribut për bilinguizmin në krahinën e Sulit. Shkroi për gramatikën e Vellarait (1985) dhe për të folmen e Hidrës, të Androsit, të Eubesë. Botoi disa përmbledhje studimesh (1996, 1997, 2000, 2011) që lidhen me etnologjinë arbëreshe dhe arvanite. Ka hulumtuar tekste të vjetra arbëreshe dhe probleme të ndryshme dialektore të arvanitëve, çështje onomastike, çështje të ballkanistikës, huazime të greqishtes në shqipen. Përktheu nga shqipja në greqisht vepra të S. Anamalit, të E. Çabejt dhe të A. Budës. (Hana Radoniqi)

JOKANOVIQ Vukashin (Vukašin Jokanović) (1939-). Politikan, ish-kryetar i Kuvendit të KSA të Kosovës. Lindi në fshatin Sllatinë të Vitisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Gjilan. Në vitin 1963 diplomoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkupit. Fillimisht punoi në Kombinatin e Duhanit në Gjilan, e më vonë ishte kryetar i komunës së Gjilanit. Nga viti 1978 deri më 1982 ishte sekretar Krahinor për Legjislacion. Në vitin 1988 u zgjodh kryetar i Kuvendit të KSA të Kosovës. Ishte deputet dhe nënkryetar i Kuvendit të Serbisë. Në vitin 1994 u zgjodh ministër Federativ i Policisë. Ishte anëtar i Partisë Socialiste të Serbisë. Jeton në Beograd. (Nerxhivane G. Dauti)

JOKIQ (Jokić) Vujadin (1928-1986). Filozof, profesor universiteti. Lindi në Velikë, komuna e Plavës në Mal të Zi. Gjimnazin e vijoi në Pejë dhe Berane, ndërsa Shkollën Normale e mbaroi në Sarajevë. Në vitin 1970, në Beograd mbrojti temën e doktoratës nga lëmi i estetikës. Një kohë punoi si ligjërues në Fakultetin e Arteve Dramatike në Beograd, më vonë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në degën filozofi-sociologji dhe në Fakultetin Filozofik në Nikshiq (Mal të Zi). Është autor i disa studimeve të veçanta, si: “Shqyrtime kritike filozofike-letrare”, “Kufijtë e filozofisë bashkëkohore”, “Raportin e poezisë dhe filozofisë” etj. (Anton K. Berishaj)

JOKLI Norbert (1877-1942). Indoeuropianist, albanist austriak. Konsiderohet një ndër studiuesit më të rëndësishëm të albanistikës. Lindi në Bzenec të Moravisë (tani në Republikën e Çekisë), në një familje hebreje. U diplomua për drejtësi në Universitetin e Vjenës më 1901. Mirëpo, interesimet e tij më shumë shkuan nga gjuhësia, të cilës ia kushtoi pjesën më të madhe të jetës. Studioi për gjuhësi indoeuropiane, sllavistikë dhe romanistikë. Më 1903 filloi punën e bibliotekarit në Universitetin e Vjenës, ku punoi deri më 1938. Nga fundit i dekadës së parë të shek. XX nisi interesimin për gjuhën shqipe. Ka dhënë mësim që nga viti 1913, ndërsa profesor u zgjodh më 1923. Shkroi një sërë punimesh për gjuhën shqipe dhe vizitoi Shqipërinë më 1937. Me ardhjen e Adolf Hitlerit në pushtet në Gjermani, artikujt e Joklit fillojnë të mos pranohen në konferenca të ndryshme. Në maj të vitit 1938 shkarkohet nga puna për shkak të origjinës hebreje, megjithëse kishte përkrahjen e dekanit. Intelektualët shqiptarë Gj. Fishta, E. Koliqi e të tjerë bënë përpjekje ta sillnin Joklin në Shqipëri, ku do të punonte si bibliotekar. Përpjekjet e tyre, ashtu si të Karlo Taljavinit nuk patën sukses për të bindur udhëheqësit e Rajhut të Tretë. Më 4 mars 1942 Jokli u arrestua nga Gestapoja dhe u dërgua në një kamp përqendrimi. Nuk ka të dhëna të sakta për vdekjen e tij. Një version thotë se është vvarë në një kamp përqendrimi në Minsk të Bjellorusisë; një tjetër thotë se ka vdekur nga kushtet e rënda në një kamp afër Vjenës; dhe një i tretë se ka bërë vetëvrasje, rrugës për në kampin e përqendrimit në Riga të Lituaniës. Në bibliotekën e tij personale ka pasur më se 3,000 tituj, përfshirë veprën e tij jetësore dhe shtojcat e shkruara me dorë në fjalorin etimologjik të Majerit. Një pjesë e madhe e këtij opusi është zhdukur. Më 1929 është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Rumanisë, ndërsa më 1936 anëtar i Akademisë së Shkencave të Danimarkës, në kohën kur indoeuropianisti dhe albanisti Holger Pedersen ishte kryetar i asaj akademie. Më 1937 mbreti Zog i dha Urdhnin e Skënderbeut. Më 1982 Universiteti i Vjenës e shënoi emrin e tij në tabelë nderi. Më 1914 realizoi atë që njihet si regjistri-



NORBERT JOKLI

mi më i vjetër në gjuhën shqipe, një përrallë, treguar nga Mustafa Abdyli i Vrapçishtit afër Gostivarit, e incizuar në Vjenë. Jokli shkroi dhjetëra artikuj studimorë për shqipen, kryesisht në gjuhën gjermane. Me rëndësi të veçantë janë monografia e tij “Hulumtime lingvistike-historikekulturore në fushën e shqipes” (Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin 1923). Vepra e tij “Hyrje në gramatikën e krahastuar historike të shqipes” (Einführung in die vergleichende historische Grammatik des Albanischen), për të cilën punoi gjatë periudhës 1913–1937 ka mbetur e pabotuar dhe ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, tok me disa punime të tjera të autorit. Vepra e tij “Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip”, përkthyer nga Eqrem Çabej, është botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës më 2011. Jokli ka inauguruar vështrimin etimologjik që merrte parasysh tërësinë e zhvillimeve të leksikut. Ai trajtoi në radhë të parë etimologjinë dhe historinë e fjalës, por burimin etimologjik ka pasur për synim ta mbështeste në një pikëvështrim sa më të plotë të saj, të formimit dhe të historisë së fjalës në të gjitha zhvillimet. Studimet e Joklit janë gurthemel i studimeve të albanistikës, meqë me veprën e tij u përpoq që shqipen ta trajtonte në radhë të parë nga brenda, e jo vetëm në aspektin e marrëdhënieve me gjuhët e tjera. (Bardh Rugova)

JONUZI Ibush (1950-). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në fshatin Pasomë të Vushtrrisë. Mbaroi Shkollën e Lartë Teknike dhe më vonë Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1983). Punën e filloi në minierën me flotacion “Trepça” në Stantërg, më pas u emërua udhëheqës teknik i punimeve të objekteve minerare, drejtues i minierës dhe drejtor teknik i minierës me flotacion “Trepça” në Stantërg (1985-1990). U burgos pas protestave të vitit 1989 dhe pas përfundimit të grevave të minatorëve. Në vitet 1992 dhe 1998 ishte deputet i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës. Pas vitit 1999 ushtroi funksione në qeverisjen lokale në Vushtrri, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2001 dhe 2004 u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në periudhën 2007-2014 ishte anëtar i bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe më vonë kaloi në menaxhmentin e “Trepçës”. Është autor i disa punimeve profesionale dhe

pjesëmarrëse në konferenca dhe në tryeza profesionale në lëmin e minierave. (Izet Zeqiri)

JONUZI Ismet (1961-). Skulptor. Lindi në Rahovicë të Preshevës. Mbaroi studimet për skulpturë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë (1983). Është anëtar aktiv i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe mësimdhënës në Fakultetin e Arteve, drejtimi i skulpturës. Ka hapur një sërë ekspozitash personale brenda dhe jashtë vendit, si në Galerinë “Karas” në Zagreb (1986), në Galerinë e Arteve të Kosovës



ISMET JONUZI

në Prishtinë (1987, 2012), në “Cite Internationale des Arts” në Paris (1987), në Leopold Hoesch Museum dhe Lutz Raahs, në Duren të Gjermanisë (1997, 1998), në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë (2002), në Galerinë Nacionale në Shkup (2005), pastaj në Brengenc të Austrisë (2011), në Malmo dhe Vaxjo të Suedisë (2008) etj., përfshirë këtu edhe ekspozitën në ambient të hapur te Ministria e Arsimit në Prishtinë (2011). Ka marrë pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta në qendra europiane dhe botërore, si dhe në disa simpoziume të skulpturës në Francë, Gjermani, Zvicër, Spanjë etj. Nga ekspozitat e përbashkëta do veçuar: Bienaljen V të Vizatimit në Pilsen të Çekisë (2006), Ekspozitën ndërkombëtare “Onufri” në Tiranë (1998), Bienalen III Ndërkombëtare të Vizatimit në Vroclav të Polonisë (2006), Bienalen IV Ndërkombëtare të Vizatimit në Melburn të Australisë (2007) etj. Është fitues i disa çmimeve profesionale, si “Grand Prix” në Bienalen IV Ndërkombëtare të Vizatimit në Melburn të Australisë (2007), çmimin e parë në “Art Revolution” në Taipei (2012), çmimin e qytetit të Durenit në Gjermani (1998) etj. Pas luftës ka qenë i përkushtuar me përdorimin e armëve shkatërruese, duke i vënë ato në funksion si material për skulpturat e tij. (Agim Rudi)

JONUZI Rafet (1964-). Skulptor, grafist. Lindi në Preshevë. Shkollimin bazë e mori në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Arteve e kreu në Prishtinë. Në fillim punoi si mësimdhënës në gjimnazin “Skënderbeu” në Preshevë, më pas hapi galerinë private “Kurchale” në

Bregenz të Austrisë, të cilën e drejton edhe sot. Realizoi disa ekspozita personale: në Galerinë “Kunstkontakt 99 Waghuss” në St. Gallen të Zvicrës, në Fondation E. Sandozet David-Neil në Paris, në Galeria “K 12” Bregenz të Austrisë, në Galerinë “Povazska” në Martin në Sllovaki, pastaj në “Povazska Galeria” në Zilina po në Sllovaki etj. dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive. Karakteristikë e veprave të R. Jonuzit është paraqitja e njeriut dhe universit përmes shprehjes ekspresive, e cila nga forma reale kalon në atë abstrakte. Ka qenë kurator i ekspozitës së artit kosovar “Ballkan demokraci” në Bregenz. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve të Austrisë dhe është paraqitur në leksikonin e artistëve të këtij vendi. Jeton dhe vepron në Bregenz. (Bislim Aliu)

JONUZI Sherif (1978-2000). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (UÇPMB), dëshmor. Lindi në Breznice, komuna e Bujanocit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Roganë të komunës së Kamenicës. Me daljen në skenë të UÇK-së u mobilizua në Zonën Operative të Karadakut, më pas në Zonën Operative të Pashtrikut. Pas përfundimit të luftës, me t’u kthyer në Gjilan, ra në kontakt me organizatorët e UÇPMB-së. Në përpjekje për të shtrirë luftën në gjithë Luginën e Preshevës, më 21 prill 2000 ra heroikisht në luftë me forcat serbe në fshatin Gjergjevc, së bashku me Enver Bajramin. (Fehari Ramadani)

JORDANI Emanuil (Emanuele Giordano) (1920-2015). Prift, albanolog. Lindi në Frasnitë të Kozencës. Ishte licencuar për teologji. Më 1945 u shugurua prift i rritit bizantin në Eparkinë e Ungrës të Kozencës dhe famullitar i Ejaninës. U mor me përkthimin e teksteve liturgjike. Në Institutin e Shkencave Religjioze G. Stamati ligjëroi liturgji, kristologji, eklesiologji, gjuhë greke, gjuhë arbëreshe dhe muzikë bizantine. Për kontributet e veçanta në kulturë dhe shërbime klerikale në vitin 2000 presidenti i Republikës së Italisë e dekoroi me titullin Komendator. Është dekoruar me Urdhrin e artë “Naim Frashëri” për meritat e tij në albanologji dhe është shpallur qytetar nderi i Elbasanit (2012). Në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare të Prishtinës ishte ndër të parët pjesëmarrës dhe

më 2004 u nderua me mirënjohje të veçantë për kontributin e dhënë në fushën e albanologjisë. Botoi: “Fjalor i Arbëreshëve t’Italisë” (1963); “Shpata Skënderbeut ndë Dibrët Poshtë” e Binard Bilotës; “Dizionario Arbëresh-Italiano” (2005); “Gramatikë arbëreshe” (2005) etj. Përktheu ungjijtë në arbërisht. (Imri Badallaj)

JOSIPI Katarina (1923-1969). Aktore. Lindi në Zym të Hasit. Shkollën fillore e nisi në vendlindje, kurse e mbaroi në Nish (Serbi). Në vitin 1941 u kthye në Kosovë dhe vazhdoi të jetonte në Ferizaj. Ishte njëra ndër aktoret e para të teatrit në Kosovë. Aktivitetin teatror e filloi në vitin 1945, në shoqërinë kulturore-artistike të organizatës “Komiteti Shqiptar” në Ferizaj. Në vitin 1947 u arrestua dhe u mbajt në



KATARINA JOSIPI

burg disa muaj, me pretextin se ishte anëtare e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare. Në vitin 1948 u pranua anëtare e trupës së Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Që atëherë, që nga roli i saj i parë në shfaqjen “Personi i dyshimtë” të B. Nushiqit (1949) e deri në premierën e shfaqjes “Tri ditët e kiametit” të L. Qafëzezit (1969), në skenën e këtij teatri K. Josipi luajti pandërprerje, kryesisht në rolet e para. Përgjatë karrierës së saj njëzetvjeçare, në skenën e TPK-së interpretoi me sukses edhe në këto shfaqje: “Pushteti”, “Martesa”, “Zhelanët”, “Zjarri dhe hiri”, “Hani në rrugën kryesore”, “Sikur të isha djalë”, “Besë”, “Dy rreshterë”, “Nuk martohem me parë”, “Shërbëtori i dy zotërinjve”, “Kryet e hudrës” etj. Ndërkaq, në vitet ’60 spikaten rolet edhe në këto shfaqje: “Cubat”, “Ushtari i mirë Shvejk”, “Tartufi”, “Dredhitë e Shaptukut”, “Tri ditët e Kiametit” etj. K. Josipi u nderua për kreacionin në rolet e interpretuara me disa çmime të rëndësishme dhe me mirënjohje të shumta. Ndër të tjera, më 1966 mori çmimin për aktoren më të mirë në Javën e Radiodramave Jugosllave, që u mbajt në Novi-Sad, pastaj mori edhe mirënjohje nga Shoqata e Artistëve të Dramës së Serbisë, çmimin e veçantë të Radio-Prishtinës për interpretimin në emisionin “Teatri në mikrofon”. Dy vjet pas vdekjes së saj, më 1971, në Teatrin Popullor Krahinor u themelua konkursi për dramën origjinale shqipe me emrin e saj, i cili u ndërpre

në fund të viteve '80 dhe u rikthye në vitin 2008. (Besim Rexhaj)

JOVANOVIQ Bozhidar (Božidar Jovanović) (1926-2014). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Pejë, shkollimin bazë e mori në vendlindje, Fakultetin Ekonomik e kreu në Beograd (1951), ndërsa më 1963 përfundoi studimet pasuniversitare. Më vonë qëndroi për specializim në Paris, doktoroi në Fakultetin Ekonomik të Shkupit dhe u zgjodh profesor i Fakultetit Juridik-Ekonomik të Prishtinës. Në këtë fakultet ushtroi detyrat e prodekanit dhe të dekanit, pastaj të prorektorit të Universitetit të Prishtinës. Ishte deputet i Kuvendit të KSA të Kosovës. Botoi një numër punimesh dhe veprash shkencore, brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilat do përmendur: “Zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe problemi i formimit të qendrave komunale” (1970), “Hyrje në bazat e filozofisë marksiste” (1982) etj. (Selman Selmanaj)

JOVANOVIQ (Jovanović) Paja (1859-1931).

Piktor. Lindi në Vërshac (Vojvodinë). Kreu studimet më 1880 dhe po atë vit ndoqi kursin e pikturës në studion e mjeshtrit Leopold



PAJA JOVANOVIQ

Carl Muller në Vjenë. Hapi ekspozita në shumë galeri europiane e botërore, ndërsa në fillim të karrierës mori pjesë në ekspozita kolektive, sidomos gjatë qëndrimit në Austri. Nga fundi i shekullit XIX udhëtoi nëpër trojet

shqiptare, ku qëndroi një kohë të gjatë. Brenda disa muajve krijoi një cikël me piktura, me njëri prej të cilëve mori çmimin e Akademisë së Vjenës në vitin 1882. Në vitin 1883 Galeria French e Londrës e porositi të realizojë tema me motive shqiptare. Qëndroi në Shkodër, ku është takuar me piktorin Kol Idromeno (1883). Pas kthimit, në bllokun e vizatimeve nga trojet shqiptare, që ruhet nga ky udhëtim, shihet se piktori shkroi dhe disa fjalë shqip. Skicat e bllokut do të përfundojnë në tabletë me ngjyra në studion e tij në Vjenë dhe, që andej, do të marrin rrugën drejt galerive të artit dhe koleksioneve të tjera europiane. Nga veprat e njohura me tema shqiptare janë: “Shqiptari me shqiponjë”, “Vallja e shpatave”, “Roja shqiptare”,

“Shqiptari duke pirë duhan”, “Lufta e gjelave”, “Dueli”, “Lahutari” etj. (Hivzi Muharremi)


JOVANOVIQ-DOBROTIN (Jovanović) Zoran (1942-). Grafist dhe piktor. Lindi në Dobrotin të Lipjanit. Kreu Shkollën e Mesme të Artit në Nish, ndërsa studimet në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1970). Në periudhën 1975-1999 ligjëroi në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Grafikati e tij i realizoi me akuatintë dhe bakërshkrim. Krijoi kompozicione shpezësh dhe kafshësh, peizazhe dhe motive të vjetra nga Prizreni. Hapi ekspozita personale në Kosovë dhe Serbi, në Beograd në “Galeria e kolektivit Grafik” dhe në Galerinë e Qendrës së Kulturës, në Galerinë e Arteve, pastaj në Muzeun e Arteve Bashkëkohore, në pavijonin “Cvijeta Zuzoriq”, si dhe në Nish, Pejë, Prishtinë etj. Mori pjesë edhe në shumë ekspozita të përbashkëta në Kosovë dhe jashtë, me çrast mori një sërë çmimesh në ekspozitat tradicionale, në Sallonin Pranveror të Kosovës (1979), në Sallonin e Tetorit në Beograd (1980), në Bienalen e Grafikës në Beograd etj. Nga viti 1999 jeton në Beograd. (Fatmir Krypa)

JOVIQEVIIQ (Jovićević) Pavle (1910-1985).

Funksionar i lartë komunist në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Lindi në Shindon të Rijekës. Erdhi si kolon me familje në Pejë. Në moshën 20-vjeçare shkoi në Francë dhe u punësua në një shkrimore. Për shkak të aktivitetit në sindikatën e punëtorëve, përjashtohet nga puna. Kthehet në Pejë në vitin 1931 dhe anëtarësohet në Partinë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Në vitin 1938 zgjidhet në Komitetin e Vendit të PKJ-së në Pejë, ndërsa në vitin 1939 bëhet anëtar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së për Kosovë. Për shkak të aktivitetit revolucionar disa herë burgoset. Më 1941 burgoset nga gjermanët, por ik nga burgu dhe me direktivë të PKJ-së shkon në Podgoricë. Kthehet në Kosovë dhe formon Aradhen e Parë Partizane në Pejë. Nga mesi i vitit 1942 u bë anëtar i Shtabit Ushtarak dhe nga prilli 1943 anëtar i Shtabit Kryesor për Kosovë. Pas vrasjes së Boro Vukmiroviqit më 1943, zgjidhet sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë. Ishte pjesëmarrës në Konferencën e Bujanit dhe nënkryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë deri në fund të luftës, kryetar i Kuvendit të Krahinës Autonome të Kosovës deri më 1960. U dekorua

me Urdhrin e Heroit të Popullit. Në Kosovë përfaqësonte krahun nacionalist serb në organet partiake dhe shtetërore. (Daut Bislimi)

JUNIKU. Qendër e komunës me të njëjtin emër. Nndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, në lartësi mbidetare prej 593 m, në të cilin jetojnë 6,084 banorë rezidentë. Nga aspekti ekonomik



JUNIKU

Juniku është qendër agrare, popullsia merret kryesisht me bujqësi. Në strukturën e tokave, sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet (43%), pjesën tjetër e zënë kullotat dhe arat. Si qendër komunale ushtron disa funksione me rëndësi: administrative, arsimore, shëndetësore, të mbrojtjes sociale, tregtare, kulturore dhe sportive, duke plotësuar kështu nevojat e popullsisë lokale. Prezenca e disa vlerave të trashëgimisë kulturore (kullat) ofron mundësi të mira për zhvillimin e turizmit kulturor, duke u vlerësuar si vend i veçantë në ofertën turistike në Kosovë dhe në rajon. Juniku ka lloje të ndryshme të peizazheve, si ai hidrografik (lumenjtë Ereniku dhe Trava), peizazhe fushore (fusha e Junikut) dhe ato kodrinore-malore (Gjeravica, Moronica). Është qendër komunale, në të cilën gravitojnë vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj. Nga objektet e standardit shoqëror Juniku ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, stacionin shëndetësor, tregun etj. (Idriz Shala)

JUNIKU (komuna). Komunë në Rrafshin e Dukagjinit, në pjesën perëndimore të Kosovës. E përbëjnë tri vendbanime: Juniku, Gjocaj dhe Jasiqi. Komuna e Junikut ka një sipërfaqe prej 78 km² dhe dendësi të popullsisë prej 78 banorë për km². Komuna e Junikut si njësi e pavarur administrative është themeluar si pilot komunë në vitin 2005, ndërsa statusin e

plotë e fitoi në vitin 2008. Komuna e Junikut ka një rritje të dukshme të popullsisë nga viti 1948 e deri më sot. Në vitin 2011 kishte 6,084 banorë, kundrejt 2,832 banorëve që kishte në vitin 1948. Pjesa më e madhe e kësaj komune është e mbuluar me pyje, me rreth 73% e territorit të saj, ndërsa pjesa tjetër me tokë bujqësore dhe ndërtim. Relievi i lartë nga ana perëndimore ndikon edhe në klimën, hidrografinë, bimësinë, shtrirjen e popullsisë dhe ekonominë e kësaj komune. Juniku ka lloje të ndryshme të peizazheve, si hidrografike (lumenjtë Erenik dhe Travë), fushore (fusha e Junikut) dhe malore (Gjeravica, Moronica). Sektori i turizmit është një nga veprimtaritë më atraktive, nga se interesimi i shfaqur për natyrën dhe trashëgiminë kulturore është në rritje. Bazuar në vlerat e shumta të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore, Juniku është në promovim të mundësive për zhvillimin e agrobiznesit, turizmit kulturor-historik dhe atij malor. (Idriz Shala)

JUNIKU Merita (1960-). Mezosoprano. Lindi në Prishtinë. Pas shkollës fillore kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. Studimet për solokëndim i filloi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë,



MERITA JUNIKU

i kreu në Akademinë e Muzikës në Zagreb. Debutoi me Verdin (Azucena), vazhdoi me operën “Trubadur” (1990) në Teatrin Kombëtar Kroat në Zagreb; me “Un ballo in maschera” në Lubjanë (Ulrika), “Osman” të I. Kuljeriqit (Nana) në Rijekë; “Requiem” dhe “Kronungs messe” të Mozartit; “Te Deum” të Brucknerit; Simfonia VIII të Mahlerit; “Petite Messe Solennelle” të Rossinit; oratorion “Elias” dhe “Endrra e një nate vere” të Mendelssohnit; oratorion “Prvi grijeh” dhe “Cum in vocarem” të Lisinskit; “Mbreti David” të Honnegerit; “Hrvatski glagoljaški rekvijem” të I. Kuljeriqit; “Requiem” të G. Verdrit etj. U vlerësua për interpretime solistike dhe shkëlqeu me teknikë vokale. Këndimi i saj u vlerësua për artikulime të pastra, intonacion e karakter të fortë. Ishte tre vjet në Teatrin Kombëtar Slloven. Interpretoi role solistike në operën “Norma” të Bellinit (Adalgisa); “Aida” të Verdit (Amneris) e “Nabucco” (Fenena), “Samsoni e Dalila” të S. Saensit (Dalila),

“Valkira” të Vagnerit (Rosweiss), “Gorenjski slavcek” të Foersterit (Majda); “Cortesova vrnitev” të P. Shicit (Pestunja), “Zigeuner Baron” të R. Straussit (Czipra), “Dasma arbëreshe” të R. Dhomit (Marlulja). Mori pjesë në festivale ndërkombëtare. Është profesore e solokëndimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Sami Piraj)

JUNIKU Neki (1942-). Psikolog, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet dhe magistraturën për psikologji në Fakultetin Filozofik



NEKI JUNIKU

të Universitetit të Beogradit. Një kohë punoi mësimdhënës i lëndës së psikologjisë në Shkollën Normale, ndërsa nga viti 1967 u zgjodh asistent dhe ligjërues i psikologjisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Bëri një specializim në Universitetin e Floridës, në SHBA më 1973. U doktorua në fushën e shkencave psikologjike në Universitetin e Prishtinës më 1989. Gjatë viteve në vijim vazhdoi punën e mësimdhënësit, duke marrë të gjithë titujt universitarë. Gjatë viteve 1999-2003 ishte dekan i Fakultetit Filozofik dhe njëri nga bashkëthemeluesit departamentit të psikologjisë në kuadër të këtij fakulteti, të cilin e udhëhoqi deri në pensionim. Është autor dhe bashkautor i disa botimeve nga fusha e psikologjisë, përfshirë edhe disa tekste për shkolla të mesme (“Modifikimi i sjelljes në shkollë”, “Terapia njohëse dhe e sjelljes në evitimin e çrregullimit të ankthit” etj.). Ka botuar edhe një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. (Kaltrina Kelmendi)

JUNIKU Resmije (1953-). Basketbolliste, trajnere. Lindi në Gjakovë. Konsiderohet basketbollistja më e mirë e Kosovës e të gjitha kohëve. Shkollën fillore dhe të mesme (Normalen) i kreu në Gjakovë, ndërsa studimet e larta (Fakultetin e Shkencave Sportive) në Prishtinë. Hapat e parë të lojës së basketbollit i filloi në KB “Vëllaznimi” të Gjakovës (1971), ku luajti për dy vjet.



RESMIJE JUNIKU

Më pas u bë anëtare e KB “Universiteti” të Prishtinës, skuadër me të cilën luajti edhe në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë (1975-1989). Konsiderohet si pioniere e basketbollit femëror në Kosovë. Ajo i takon “brezit të artë” të KB “Universiteti”, skuadër që mbante gjithmonë mesin e renditjes në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Ka dhënë kontribut në basketboll edhe si trajnere dhe instruktore. Ishte përzgjedhëse e përfaqësueses së Kosovës për femra. Për punën dhe kontributin në sport disa herë është zgjedhur sportiste e vitit në Kosovë. Në edicionin 1977-1978 u zgjodh organizatorja më e mirë e lojës në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Punon si mësimdhënëse e edukatës fizike në gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë. (Bekim Aliu)

JUSTINI (Flavius Justinus) (450-527). Perandor i Bizantit me prejardhje dardane, nga Bederiana e Dardanisë. Ishte xhaxhai dhe paraardhësi i perandorit Justinian. I ardhur në Konstantinopojë për një jetë më të mirë, u rekrutua në ushtri dhe në saje të aftësive ushtarake, u zgjodh komandant i Gardës Perandorake. Pas vdekjes së perandorit Anastas, me zgjedhjen e ushtrisë dhe miratimin e popullit dhe Senatit u zgjodh perandor (518). Njihej për përpjekjet e tij për uljen e tensioneve dhe mosmarrëveshjeve religjioze ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Dha kontribut të çmuar në fushën e legjislacionit, ndërtimeve dhe në mbrojtjen dhe stabilizimin e Perandorisë Bizantine. Para vdekjes, emëroi Justinianin, nipin e tij, për bashkëperandor. (Emine Kalaja-Hajdari)

JUSTINIANA EDYTË (Iustiniana Secundae). Qytet i rëndësishëm i antikës së vonë në Dardani. Ndodhet në afërsi të Graçanicës, rreth 8 km në juglindje të Prishtinës. U themelua nga perandori bizantin, Justiniani, mbi rrënojat e qytetit antik të Ulpianës, pasi e shkatërroi tërmeti i vitit 518. Sipas Prokopit të Cezaresë (“Mbi Ndërtimet”), Justiniani i rindërtoi muret e shkatërruara të qytetit dhe ndërtoi objekte të shumta luksoze, duke ia kthyer qytetit madhështinë e dikurshme dhe duke ia vënë emrin Iustiniana Secundae. Qyteti vazhdoi të jetë qendër e rëndësishme xehtare dhe në afërsi, sipas burimeve, Justiniani ndërtoi qytetin me emrin Justinopol. Justiniana e Dytë vazhdoi të jetë qendër e rëndësishme ekonomike, politike dhe religjioze. Ishte



JUSTINIANA E DYTË

dhe qendër ipeshkvnore, por tani nën argjipeshkvinë e re të Justinianës së Parë. Ishte aktive në mosmarrëveshjet doktrinale të krishterimit që e karakterizuan shek. VI. Në vitin 552, si rezultat i mosmarrëveshjeve rreth aferës së Tre Kapitujve (Tria Capitula), në qytet shpërtheu një konflikt i armatosur ndërmjet të krishterëve. Për shuarjen e konfliktit u dërguan edhe trupa ushtarake, të cilat për një kohë qëndruan aty. Këtë duket e konfirmon dhe prezenca e kastrumit afër qytetit. Qëndrimet rreth mosmarrëveshjeve të Tre Kapitujve si dhe korrespondencat e papëve me ipeshkvitë dardane lënë të kuptohet se qyteti, ndonëse ishte në sferën e influencës së Konstandinopojës, ishte i lidhur me shumë me Selinë Apostolike të Romës. Megjithatë qyteti kishte emër të ri, ipeshkvi i saj Pali në Koncilin V Ekumenik të Konstandinopojës është nënshkruar si peshkop i Ulpianës (episcopus Ulpianensis). Qyteti konsiderohet edhe si vendlindje e ipeshkvit monofizit Gergentit, i cili vepronte në brigjet e Detit të Kuq si argjipeshkëv i Safares (shek. VI). Hulumtimet arkeologjike të karakterit mbrojtës në lokalitet nisën nga Muzeu i Kosovës në vitin 1953 (E. Çershkov) dhe ato sistematike më 1954, për të vazhduar me ndërprerje deri në ditët e sotme. Mbetje të Justinianës së Dytë janë pjesët e murit rrethues, porta veriore me kulla mbrojtëse, ajo perëndimore, bazilika njëanijatëshe, mbetjet të rrugës kardo, disa ndërtesa, kastrumi jashtë mureve në lindje. Në gjysmën e parë të shek. VII vendbanimi u braktis

përfundimisht, si rezultat i shkatërrimeve të sulmeve avaro-sllave. (Arben Hajdari)

JUSTINIANA E PARË (Justiniana Prima).

Qytet i antikës së vonë. E ndërtoi për një kohë të shkurtër perandori bizantin Justiniani i Madh, me prejardhje nga fshati Taurisium i Dardanisë (viti 535). Siç njofton Prokopi i Cezaresë (“Mbi ndërtimet”) Justiniani e pajisi qytetin me mure mbrojtëse, sheshe, tempuj, fontana, ujësjellës etj. dhe e bëri qytet metropol të Dardanisë dhe qendër ipeshkvnore të Ilirikut. Qyteti u rrit shpejt dhe perandori e barti selinë nga Selaniku në Justinianën e Parë (535). Ai emëroi kryeipeshkvinë e re, duke i shkëputur nga Ekzarkati i Selanikut shtatë provincat: Mezinë e Epërme, Dardaninë, Dakinë Mesdhetare, Dakinë Ripensis, Prevalitanën, Maqedoninë e Dytë dhe një pjesë e Panonisë së Dytë. Kryedioqeza e Justiniana Primës përmendet për herë të fundit në vitin 602. Anarkia që mbretëroi në rajon nga vdekja e perandorit Maurice dhe dyndjet sllave shkatërruan organizimin kishtar dhe Justiniana e Parë u shkatërrua në masë të madhe. Basili II, fitimtar i bullgarëve, themeloi kryepeshkopatën e Ohrit (fillimi i shek. XI) dhe titullari i selisë së re, për të rritur prestigjin, pohoi se Ohri mund të identifikohet me qytetin e themeluar nga Justiniani në shek. VI, ndërsa Gjon Komneni nënshkroi aktet e sinodit të takuar në Konstandinopojë (1157), ku thuhet se Argjipeshkvia e Justinianës së Parë përfshinte edhe gjithë Bullgarinë. Qyteti përmendet për herë të fundit në aktet kishtarë të vitit 602 dhe argjipeshkvi i fundit i saj ishte Gjoni. Disa studiues mendojnë se u shkatërrua nga sulmet avaro-sllave (gjysma e dytë e shek. VII), kurse disa të tjerë se hyri nën zotërimin bullgar. Mendohej se qyteti gjendej afër Shkupit, por pas gërmimeve franceze-jugosllave dhe më pas, qyteti u identifikua me Cariçin Grad, lokalitet rrëzë bjeshkës së Radanit te Lebane (Serbi). (Arben Arifi)

JUSTINIANI (482-565). Perandor bizantin, me prejardhje nga fshati Tauresium i Dardanisë. Drejtoi Perandorinë e Bizantit nga viti 527 deri në vdekje dhe u njoh si Justiniani i Madh. Studioi në Konstandinopojë për drejtësi, teologji dhe histori romake dhe nga Justin I u thirr për ta drejtuar seksionin e administrimit publik. U martua me Teodorën, pasi Justin I lejoi

ligjin për martesë midis shtresave shoqërore dhe kjo pat ndikim të madh në vendimet e tij. Ishte një prej figurave më të rëndësishme të antikitetit të vonë dhe ndoshta perandori i fundit latinofon. Njihet si perandor që kishte për synim restaurimin e Perandorisë Romake, që u realizua pjesërisht. U shqua me reformat juridike, sidomos me revizionin e të Drejtës Romake. Legjislatura e Justinianit njihet përmes “Korpusi i të drejtës civile”, e cila përbëhet nga “Kodeksi i Justinianit”, “Digesta”, “Institutionet” dhe “Novelat”. Me qëllim të frenimit të zbritjeve të “barbarëve” nga kufijtë veriorë, i kushtoi vëmendje të veçantë ngritjes së një sistemi fortifikatash në disa breza, që fillonte nga vija kufitare e Danubit në veri dhe zhvillohej valë-valë duke zbritur në drejtim të jugut. Vetëm në Dardani meremtoi 61 kështjella dhe ndërtoi nga themelet 8 kështjella të tjera. E ndërtoi qytetin e madh në vendlindje, që ia dha emrin Justiniana Prima dhe e bëri kryeqendër ipeshkvnore. Rindërtoi qytetin e Ulpianës dhe e emëroi Justiniana Secunda, pranë së cilës ngriti dhe qytetin tjetër dhe për nder të xhaxhait Justinin e quajti Justinopol. (Arben Arifi)

JUSTINOPOLI. Qytet i paidentifikuar në Dardanië e antikës së vonë. Përmendet nga Prokopi i Cezaresë (shek. VI), i cili thotë se perandori bizantin, Justiniani, themeloi qytetin që e quajti Justinopol, për nder të ungjit të tij Justinin, fronin e të cilit e trashëgoi. Ai cek se qyteti u ndërtua afër Justiniana Sekundës, Ulpianës së mëparshme të rrënuar nga tërmeti i vitit 518, dhe ai nuk e ka tejkaluar hijeshinë e Justiniana Sekundës dhe nuk e ka zbehur emrin e Justinianit. Përderisa Justinopoli i Dardanisë u ndërtua nga perandori Justinian, vetë Justinin i quajti në emër të tij qytetet në Kiliki, Bithyni, Kapadoki, Istri etj.

Tentimet për ubifikimin e Justinopolit janë të kahershme dhe ende vazhdojnë, ndonëse ndërkohë është ubifikuar Ulpiana te Graçanica. Një supozim është se qyteti u ndërtua në vazhdim apo ngjitur me Justiniana Sekundën. Ka më shumë gjasë që me të identifikohet qyteti me fortifikatë në kodrën e Veletinit, e cila qëndron midis fshatit Shashkocv dhe Janjevës, rreth 5 km në juglindje të Justiniana Sekundës. Veletini (969 m) ka fortifikatë në trajtë poligonale të parregullt, me tri tarraca dhe mure masive rrethuese (2.40 m). Vendbanimi shtrihet dhe jashtë mureve

rrethuese dhe ka gjurmë të shumta të themeleve të godinave e të kishave, të atyre paleokristiane e mesjetare. Qyteti është ngritur në arealin e minierave të çmueshme dhe kishte një pozitë mbrojtëse e mbikëqyrëse të vetë qytetit Justiniana Secunda dhe duket se ka qenë dhe strehimore e banorëve të saj në rast rreziku. (Arben Arifi)

JUSUFI Fahrudin (1939-). Futbollist, trajner. Lindi në Dragash. Ishte një nga mbrojtësit më të mirë të kohës dhe bëri karrierë si futbollist dhe trajner. Në fillim (1955-1957) luajti për të rinjtë e “Partizanit” të Beogradit dhe më pas në skuadrën e parë të këtij kampioni të shumëfishtë të ish-Jugosllavisë (1957-1966). Në periudhën 1966-1970, luajti për skuadrën gjermane “Eintracht Frankfurt” dhe më vonë ishte anëtar i skuadrës “Germania Wiesbaden” dhe “Dornbirn”. Për përfaqësuesen e ish-Jugosllavisë luajti në periudhën 1959-1967 dhe zhvilloi 55 ndeshje. Në vitin 1980-1981 F. Jusufi ishte menaxher i skuadrës “Schalke 04”, kurse më vonë drejtoi skuadrën “SG Wattenscheid 09”, pastaj “1860 Munich” dhe, së fundi, drejtoi skuadrën e Partizanit të Beogradit. Jeton në Beograd. (Besim Kajtazi)

JUSUFI Lumnije (1977-). Gjuhëtare, përkthuese. Lindi në Kërçovë. Shkollën e mesme e kreu në Dortmund (Gjermani), studimet në Munih dhe në Kozencë (Itali). Studimet pasuniversitare i kreu më 2005, ndërsa u doktorua më 2009 në Munih me temën rreth të folmeve të gegërishtes qendrore në Maqedoni. Nga viti 2014 është bashkëpunëtor shkencor dhe drejtues e projektit “Kufiri shqiptaromaqedon dhe ndikimi i tij gjuhësor në rajonin e Dibrës” në Universitetin Humboldt në Berlin. Është autore e shumë artikujve shkencorë, e librit “Hyrje në gjuhën shqipe” (Einstieg Albanisch) për mësimdhënien e shqipes për gjermanishtfolës në bashkëpunim me Isabel Ströhlen (Hueber, 2012). Është përkthuese shqip-gjermanisht-shqip, docente në fushën e albanologjisë dhe të gjermanistikës, ka mbajtur ligjërata në Universitetin e Prishtinës, në Universitetin e Munihut, në Universitetin e Tetovës, në Universitetin e Elbasanit, në Universitetin Teknik të Dortmundit dhe në Institutin Goethe në Tiranë. (Bardh Rugova)

JUSUFI Mehmet (1927-2004). Gjeograf, aktivist i arsimit. Lindi në Preshevë. Shkollën


fillore e mbaroi në vendlindje në gjuhën serbe, ndërsa gjimnazin në Vranjë. Pas Shkollës së Lartë Pedagogjike në Nish, vazhdoi studimet në Universitetin e Shkupit, dega e gjeografisë, ku edhe u diplomua. Dha një kontribut të çmuar në fushën e arsimit dhe të edukimit në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës. Luajti një rol të madh në zgjerimin e rrjetit shkollor. Një meritë të madhe kishte në hapjen e paraleleve të gjimnazit në Preshevë, si pjesë të gjimnazit të Vranjës, duke ushtruar detyrën e zëvendës drejtorit dhe duke mbajtur mësim në lëndë të ndryshme. Me pavarësimin e gjimnazit në vitin 1963, zgjidhet drejtor i tij. Ndërkaq, pas Plenumit të Brionëve zgjidhet kryetar i komunës së Preshevës dhe deputet në Kuvendin e Serbisë. Botoi një artikull shkencor në revistën "Përparimi" për Preshevën me rrethinë. Pas pensionimit (1981) jetoi në Prishtinë dhe në Portorozh të Sllovenisë. (Hivzi Islami)

JUSUFI Ramadan (1917-1983). Gjeograf, veprimtar. Lindi në Čerñićë të komunës së Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Medresenë e Madhe në Shkup. Studimet për gjeografi dhe etnografi i filloi para Luftës së Dytë Botërore në Shkup dhe i përfundoi në Beograd (1946). Gjatë luftës punoi referent i pylltarisë në Gjilan, ndërsa më 1943 emërohet kryetar i komunës së Bresalcit. Më pas punoi në Drejtoratin Krahinor për Arsim e Kulturë në Prizren, ku u angazhua rreth kurseve të para pedagogjike. Më pas ishte mësimdhënës dhe drejtor i shkollave të mesme anëmbanë Kosovës. Ishte veprimtar i shquar i çështjes kombëtare dhe përkrahës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për çka u dënua me 2 vjet burg nga Italia fashiste. Më 1981 u largua nga pozita e drejtorit të Shkollës së Mesme Ekonomike në Prishtinë, për shkak të përkrahjes së demonstratave të studentëve. U mor me përpilimin dhe përkthimin e teksteve shkollore, si dhe botoi disa punime shkencore nga lëmi i gjeografisë, nga të cilat veçohet: "Mbi bifurkacionin e Nerodimes dhe ndërrimin e burimit të Sitnicës". (Mehmet Halimi)

JUSUFI Selim (1949-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Llabjan të Novobërdës. Shkollimin bazë e kreu në Prishtinë, studimet për kimi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës

(UP) në vitin 1972. Studimet pasuniversitare i përfundoi në FSHMN të Universitetit të Zagrebit (1981), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të UP-së (1986). Punoi mësimdhënës i kimisë në Shkollën e Mesme Teknike në Obiliq. Më 1973 u zgjodh asistent në seksionin e kimisë në FSHMN të UP-së, ku punoi vite me radhë dhe mori të gjithë titujt universitarë. Ushtrroi disa funksione në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës dhe ishte redaktor i revistës "Acta Chimica Kosovica". Ka publikuar punime në revista shkencore dhe ka mbajtur kumtesa në tubime shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Është autor i teksteve shkollore dhe bartës i disa projekteve. (Salih Gashi)

JUSUFI Selman (1950-). Aktor, regjisor, poet. Lindi në Nivokaz të Gjakovës. Kreu Shkollën Normale në Gjakovë, ndërsa studimet për aktrim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në



SELMAN JUSUFI

Prishtinë. Në periudhën 1973-1985 punoi si aktor në Teatrin e Kombësive në Shkup, kurse më pas në Teatrin Popullor Krahinor, përkatësisht në Tetarin Kombëtar të Kosovës në Prishtinë. Shquhet për ekspresionin e tij vokal dhe trupor, që i mundësuan të jetë protagonist i një numri shfaqjesh të arrira në Teatrin e Shkupit dhe në Teatrin e Prishtinës. Është laureat i një sërë çmimesh për kreacione artistike. Në vitin 1983 u shpall aktori më i mirë në Maqedoni për rolin e Halil Garrisë në shfaqjen "Unë, Halil Garria" të B. Musliut dhe për rolin e Vangut në dramën "Bohçja" të E. Bondit. Role të rëndësishme realizoi edhe në shfaqjet "Pahintikë në ëndërr", "Nëna shkon në parajsë", "Shpend Sokoli i Sokol Shpendit", "Vegullia", "Mbreti Lir", "Xhaxha Vanja", "Orestia", "Historia e atyre që s'janë", "Ëndrra e qenit" etj. Një nga rolet më të realizuara në Teatrin Kombëtar të Kosovës është roli i Xhezairit në "Vdekja më vjen prej syve të tillë" (1999) në regji të F. Hysajt. S. Jusufi realizoi edhe një numër shfaqjesh si regjisor: "Krushqit janë të ngrirë" (1993), "Burgu i hapur" (1999), "Palimpsest" (2001), "Toka e premtuar" (2003), "Nirvana" (2008) etj. Është autor i një sërë shkrimesh publicistike për

teatër dhe i disa librave me poezi dhe ese. Për punën e frytshme në teatër u nderua me çmime dhe mirënjohje. Në vitin 2015 nga Ministria e Kulturës e Kosovës mori çmimin kombëtar për veper jetësore. (Fadil Hysaj)

JUSUFI Shefki (1952-2004). Inxhinier i metalurgjisë. Lindi në fshatin Tuhin të Kërçovës (Maqedoni). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen teknike në Gostivar, ndërsa studimet i filloi në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe i përfundoi në Fakultetin e Teknologjisë dhe të Metalurgjisë në Beograd (1978). Po në Beograd kreu edhe studimet pasuniversitare. Në vitin 1978 punësohet në Institutin për plumb dhe zink “Trepça” në Zveçan, pastaj në ndërmarrjen punuese në ndërtim “Ferronikeli” në Drenas, ku kreu një varg detyrash me përgjegjësi në fazën e zhvillimit të projektit dhe të ndërtimit të “Ferronikelit”. Kreu disa specializime nga lëmi i metalurgjisë së ferrolegurave. Gjithashtu ka ushtruar funksione me përgjegjësi në “Ferronikel”: shef i shërbimeve teknike, udhëheqës i furrave elektroharkore dhe drejtor i shkrites. Ishte asistent për disa lëndë profesionale në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik në Mitrovicë. (Shyqeri Kelmendi)

JUSUFI Xhevat (1953-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Vidishiq të Mitrovicës. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe nga viti 1973-1977 punoi si mësimdhënës në fshatrat Selac dhe Bare të Shalës së Bajgorës. Gjatë shërbimit ushtarak mori gradën e kapitenit rezervë. Në vitin 1979 u punësua në Entin e Statistikave të Kosovës - drejtoria në Mitrovicë. Ishte njëri nga organizatorët e demonstratave të vitit 1981 në rajonin e Mitrovicës. Disa herë u mor në biseda informative në organet policore të asaj kohe për shkak të veprimtarisë së tij. Në periudhën 1991-1995 punoi si arsimtar dhe më pas drejtor shkolle në fshatin Bare. Në fillimit të vitit 1998 u inkuadrua në radhët e UÇK-së, në rajonin e Shalës së Bajgorës. Zyra e tij si drejtor shkolle shërbeu për takime dhe konsolidimin e radhëve të UÇK-së. Dha kontribut në formimin e Brigadës 141 “Mehë Uka”, në të cilën u inkuadrua që me themelimin e saj në qershor të vitit 1998. Në shtator të atij viti u emërua ndihmëskomandant për logjistikë në Zonën Operative të Shalës. Këtë detyrë e kreu deri në ditën e rënies heroike më 3 janar 1999. Në vitin 2013 presidentja e Republikës së Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Miftar Kurti)

K

KABA Liman (1924-1945). Pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare, Hero i Popullit i Jugosllavisë. Pas shkollës fillore në Dibër, mësoi në Gjinnazin në Prishtinë, ku veproi në organizimin e rinisë antifashiste. Për këtë arsye në vitin 1942 u arrestua dy herë. Iku nga burgu i Prishtinës dhe u kthyer në Dibër. Edhe këtu veproi si organizator i Lëvizjes. Shtëpia e tij ishte qendër e mbledhjeve ilegale dhe aty u formua Komiteti Lokal i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) për Dibër. Në shkurt të vitit 1943 kaloi në Tiranë. Në maj të vitit 1943 u bë luftëtar i njësisë partizane “Dajti”. Mbas kapitullimit të Italisë u gjend sërish në Dibrër, ku u caktua zëvendëskomisar i çetës në Komandën e Qytetit dhe më vonë u inkuadrua në Brigadën e Katërt (gusht 1944) Maqedonase. Po atë vit u pranuan anëtar i PKJ-së. Ishte edhe zëvendëskomisar politik në Batalionin e Korpunit të Pesëmbëdhjetë (maqedonas) të UNÇJ-së. Ra në luftë me fuqitë çetnike në frontin e Sremit në Sllavinë Perëndimore. Në vitin 1953 u shpall Hero i Popullit të Jugosllavisë. (Izber Hoti)

KABASHI Astrit (1975-). Aktor, skenarist, profesor universiteti. Lindi në Gjurakoc të Istogut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Istog. Kreu studimet



ASTRIT KABASHI

në shfaqjet “Mbreti Ibish”, “Maturantët”, “Ma-

për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP). Nga viti 2004 punon si mësime të aktrimit në Fakultetin e Arteve të UP-së. Fillimisht, nga viti 1998 ka luajtur në Teatrin “Dodona” në Prishtinë,

kiato boys” dhe më pas “Mësimi” dhe “Galani”. Nga viti 1999 e tutje ka luajtur edhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës në shfaqjet: “Hamleti”, “Shfaqja e fundit”, “Komedia”, “Trëndafilu tatuazh”, “Pallati i ëndrrave”, “Magjistari nga Ozi”, “Aromë portokalli”, “Togeri nga Inishmori”, “Rikardi III”, “Exit”, “Arushani & Fejesa”, “Çifti Martin” etj. Në Teatrin e Gjilanit luajti në shfaqjen “Vegullia”. Disa role i interpretoi edhe në filma të metrazhit të gjatë, si: “Exit”, “Shkaba”, “Kukumi”, “Babai”, si dhe në disa filma të metrazhit të mesëm dhe të shkurtër (“Kaseta e dasmës”, “Dëshira e fundit”, “Der Schübling”, “Tri ngjyrat”, “Relax”, “Shok” etj.). Njihet edhe si aktor i serialeve televizive vendore, si: “Kafeneja jonë”, “Familja moderne”, “Çka ka shpia” etj., si dhe i serialit belg “Tytgat Chokolat”. Është skenarist i serialit televiziv “Kafeneja jonë”. Për kreacionet artistike fitoi disa çmime: për rolin kryesor në filmin “Babai” në Filmfest Munhen (Gjermani, 2015), në kategorinë e aktorit u nderua me çmimin “German Cinema New Talent Award”, ndërkaq më 2016 me çmimin e aktorit më të mirë në “Premiers Plans-Angers Film Festival” në Francë. (Bekim Lumi)

KABASHI Bajram (1957-). Gazetar. Lindi në Tomoc të komunës së Istogut. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjurakoc, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1982 filloi punën si gazetar në gazetën e përditshme “Rilindja”. Për vite me radhë ka shkruar raporte dhe shkrime autoriale për problematikën edukative-arsimore në Kosovë. Në vitet ’90, pas mbylljes së “Rilindjes” nga Serbia, vazhdoi punën e gazetarit në gazetën “Bujku”, ku ushtroi edhe detyrën e zëvendëskryeredaktorit. Është autor i disa veprave publicistike: “Me Hasan Mekulin”

(1997), “Rilindja: përkushtim dhe trishtim” (2001), “Baleta më ka thënë: vetëm nacionalizmi e shpëton kombin shqiptar” (2005) etj. Jeton në Norvegji. (Behlul Jashari)

KABASHI Bashkim (1937-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Kukës, Shqipëri. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren. Një kohë punoi mësues në fshatin Vermicë të komunës së Prizrenit. Studimet e rregullta dhe ato pasuniversitare nga lëmi i hidroteknikës bujqësore i mbaroi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit (1965). U punësua në Institutin Bujqësor në Pejë. Kreu specializime në Wageningen, Holandë. Në vitin 1968 zgjidhet ligjërues në Shkollën e Lartë Bujqësore në Prishtinë. Më 1976 zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. Tezën e disertacionit e mbron në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Shkupit (1979). Në vitet vijuese mori të gjithë titujt universitarë. Ka ushtruar funksione të ndryshme në institucione arsimore dhe ka qenë drejtor i Hidrosistemit “Ibër Lepenc”. Ka publikuar punime shkencore e profesionale dhe tekste universitare (“Parimet dhe praktika e ujitjes”, “Komasacioni i tokave”). (Xhevdet Elezi)

KABASHI Besim (1972-). Specialist i gjuhësisë kompjuterike. Lindi në Istog. Kreu studimet për informatikë në Nyrnberg-Erlangen, Gjermani. Studioi informatikë gjuhësore dhe gjuhësi gjermane dhe mori titullin




BESIM KABASHI

“Magister Artium”. Nga viti 2003 është lektor dhe gjurmues në degën e gjuhësisë kompjuterike në Erlangen. Më 2014 mbrojti doktoratën “Përpunimi automatik i morfologjisë së shqipes”. Merret kryesisht me

studime midis gjuhësisë dhe informatikës, përpunimit teknik të gjuhëve natyrore/njerëzore, në veçanti njohjen, analizën dhe prodhimin e fjalëve/fjalëformave, me leksikografi, shënjim automatik gjuhësor të teksteve, gjuhësi të korpusëve të teksteve, ndërtim të resurseve gjuhësore dhe të resurseve të dijes dhe zbatim të metodave të statistikës në gjuhësi. Botoi artikuj në përmblendje të konferencave dhe revista shkencore, ndër to: “Klitikat përemërore dhe valenca në

shqipen. Një vrojtim kompjutacional dhe modelim në kuadër të LAG” (Pronominal clitics and Valency in Albanian. A computational linguistics perspective and modelling within the LAG-Framework, Berlin 2007); “Alfabeti i shqipes nga aspekti i vështrimit gjuhësor teknologjik” (Das Albanische Alphabet aus sprachtechnologischer Sicht, Hamburg 2009); “Korpuse gjuhësore për shqipen” (Prishtinë, 2012). (Lindita Rugova)

KABASHI Emin (1949-). Shkrimtar, publicist. Lindi në Çifllak të Rahovecit. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa të mesmin në Prizren e Rahovec. Ndoqi studime për gjuhë dhe



EMIN KABASHI

letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës, ku i vazhdoi edhe studimet pasuniversitare. U doktorua me poetikën e poemave të Jeronim de Radës. Punoi si mësues dhe arsimtar i gjuhës shqipe në shkolla të ndryshme të Kosovës.

Nga viti 1992 deri në pensionim punoi si punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e letërsisë. Botoi romane, drama dhe libra studimorë. Romanet: “Njerëz dhe rrugë” (1990), “Dimri i Drinisë” (1993), “Përtej grilave” (1997), “Nusëria e Pinceshës” (2001); dramati: “Gjaku i shprishur” (1993), “A erdhi nusja” (2002), “Liria” (2003); studime letrare e historike: “Poetika e poemave të Jeronim de Radës” (1993), “Lasgush Poradeci, jeta dhe vepra” (1997), “Kadare- mendësia shqiptare” (1998), “Robëria, iluzionet, shqiptarët” (1998), “Batalioni ‘Atlantiku’ i UÇK-së” (2004). Shquhet për interesime të shumta rreth letërsisë, për luftën, për autorë klasikë dhe bashkëkohorë të letërsisë shqipe. Është autor i shumë vështrimeve e recensioneve në të përditshmet dhe revistat letrare. Puna e tij u vlerësua edhe me çmime letrare. (Kujtim Rrahmani)

KABASHI Hasan Ibrahim (1901-1945). Luftëtar i rezistencës antikomuniste. Lindi në Kabash të Vitisë. Babai i tij ishte luftëtar i dalluar kundër pushtuesve osmanë, i vrarë më 1910. Për shkak të represionit serb, në vitin 1929 së bashku me familje shpërngulet në Shqipëri. Më 1941 kthehet në Kosovë dhe emërohet kryetar komune në Bresalc të Gjilanit. Pas kapitullimit të Bullgarisë kthehet në Kabash

dhe emërohet kryetar komune në Viti. Së bashku me kryetarët e tjerë të Anamoravës dërgoi forcat vullnetare për mbrojtjen e kufirit lindor të “Shqipërisë Etnike”. Nuk u pajtua me pushtetin e vendosur nga forcat partizane në nëntor të vitit 1944 dhe vazhdoi qëndresën kundër ripushtimit jugosllav. Në Kuvendin e Kopilakës më 15-16 gusht 1945 u emërua komandant i batalionit të parë të forcave të rezistencës. Me bashkëluftëtarët e tjerë, në tetor të vitit 1945, vendosën të tërhiqen për në Greqi. Në një përpjekje me forcat jugosllave vritet më 28 nëntor në kufirin jugosllavo-grek, afër Manastirit. (Adem Murati)

KABASHI Imzot Hil (1941-). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Caparc afër Prizrenit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, kurse shkollimin për meshtar e filloi në Pazin (Kroaci) dhe e vazhdoi në Visoko (Bosnjë e Hercegovinë). Fakultetin Teologjik e kreu në Sarajevë, ku edhe u shugurua meshtar, kurse meshën e parë e mbajti në Gjakovë (1969). Shërbeu si kapelan në Bugojno e Bihaq të Bosnjës e Hercegovinës. Në vitin 1971 u caktua të shërbejë në Gjakovë, ku përktheu dhe përgatiti për botim këngët për liturgji “Këndoni Zotit një këngë të re”. Për dy vjet udhëhoqi revistën dymujore “Drita”. Gjatë kohës që shërbeu në Gjakovë ndërmoi aksionin për pajtimet e gjaqeve dhe të ngatërresave, ndërkaq për 20 vjet kreu detyrën e misionarit në Misionin Katolik Shqiptar në Shtutgart të Gjermanisë. Në vitin 1996 u emërua ipeshkëv në Shqipërinë e Jugut me seli në Fier, përkatësisht nga viti 2006 me seli në Vlorë. (Frrok Kristaj)

KABASHI Jashar (1940-). Gjuhëtar, përkthyes, profesor. Lindi në Kabash të Prizrenit. Shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Prizren. Studimet për gjuhë angleze i ka mbaruar në Prishtinë më 1966,



JASHAR KABASHI

SHBA si bursist i Fullbrajtit. Është doktoruar në Zagreb më 1988 me temë që lidhet me matjen e kompetencës

së anglishtes si gjuhë e huaj. Ka qenë profesor mysafir në Universitetin e Uestminsterit në Londër me ftesë të Këshillit Britanik. Punoi fillimisht në gjimnazin e Prizrenit e prej vitit 1968 punoi në degën e gjuhës dhe të letërsisë angleze në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, ku është pensionuar si profesor i rregullt. Më 1999 ka qenë udhëheqës i sektorit të përkthimit në Administratën e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Punimet e tij studimore lidhen kryesisht me morfologjinë, me përkthimin, kontaktet e gjuhëve dhe kompetencën e anglishtes si gjuhë e dytë. Në vitin 2000 ka botuar një libër të morfologjisë së anglishtes. (Lindita Rugova)

KABASHI Mustafë Arif (1866-1910). Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare në rajonin e Anamoravës. Lindi në Kabash të Vitisë. Bashkëveprimtar i ngushtë dhe njëri ndër katër “bajraktarët” e Idriz Seferit. Në mars të vitit 1910 mori pjesë në mbledhjen e parisë shqiptare të Anamoravës në Gjiilan, ku u vendos për kryengritje të armatosur kundër pushtetarëve xhonturq. U dallua si organizator dhe udhëheqës në luftimet e kryengritësve shqiptarë kundër ushtrisë osmane të prirë nga Shefqet Turgut Pasha në Grykën e Kaçanikut më 28 prill 1910. Bashkë me Idriz Seferin iu prinë kryengritësve në luftimet afër Korbliqit, në Drenogllavë, Nikoc, Smirë, Goshicë, Binçë dhe Kabash. Pas shuarjes së kryengritjes, M. Kabashi, me të vëllanë Ademnin dhe kushëririn Ibrahimin, u zunë rob nga ushtria osmane dhe u pushkatua në Gjiilan. (Adem Murati)

KABASHI Naser (1962-). Inxhinier i ndërtimeve, profesor universiteti. Lindi në Gurakoc të Istogut. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe Istog, ndërsa studimet




NASER KABASHI

në Prishtinë. Kreu studimet pasuniversitar në Zagreb (1989), ndërsa ato të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (UP). Në vitin 1988 u zgjodh asistent dhe më pas merr titujt përkatës universitarë në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe të Arkitekturës të UP-së. Punën hulumtuuese shkencore e zhvilloi në disa institucione dhe universitete: në Institutin “IRMA” në Slloveni,

në laboratorin "MAPEI" në Itali, në laboratorin "IMP-Bau test" në Zvicër, në Universitetin Lueven në Belgjikë, në Universitetin e Teknologjisë në Bratislavë të Sllovakisë. Aktiviteti i tij profesional është i lidhur me një numër të madh projektesh profesionale. Është i angazhuar edhe në procesin mësimor në Universitetin Shtetëror të Tetovës që nga viti 2008. Botoi tekstin universitar "Materialet polimere dhe bituminoze" (2008) dhe disa dispensa. Është autor i një sërë punimesh profesionale në revista të ndryshme dhe ishte pjesëmarrës në shumë konferenca ndërkombëtare. Ishte dy mandate dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës. (Fetah Jagxhiu).

KABASHI Rustë (1835-1910). Organizator dhe udhëheqës i çetave antiosmane. Lindi në Kabash të Prizrenit. Mori pjesë në organizimet dhe në aktivitetet luftarake të Lidhjes së Prizrenit. Ishte organizator e pjesëmarrës i kuvendeve dhe tubimeve popullore për organizimin e kryengritjeve antiosmane të viteve 1884-1885. Më pas, në vitin 1910 ishte organizator i kryengritjeve në Prizren me rrethinë. Për shkak të aktivitetit patriotik, pushteti osman e arrestoi dhe më pas e dënoi me vdekje. U ekzekutua me varje në litar në sheshin kryesor të Prizrenit më 18 gusht 1910. Sipas të dhënave, kufoma e tij, me urdhër të pushtetit osman nuk u lejua të merret nga familjarët, në shenjë hakmarrje për veptrimarinë e tij. (Frashër Demaj)

KABASHI Zenel (1942-) Mjek, internist, gastroenterolog, profesor universiteti. Lindi në fshatin Kabash të Prizrenit, shkollën fillore e kreu në Korishë, ndërsa gjimnazin real në Prizren. Dy vjet punoi si mësues. Në vitin 1960 regjistroi Fakultetin e Mjekësisë në Novi-Sad, më pas i vazhdoi studimet në Sarajevë. Një kohë punoi në repartin e pneumoftiziologjisë në Spitalin Rajonal të Prizrenit. Dha mësim edhe në shkollën e mesme mjekësore në Prizren. Më 1974 u pranua në Klinikën Interne të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Specializoi në lëmin e mjekësisë interne dhe pas studimeve pasuniversitare u zgjodh asistent i po kësaj lënde në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978).



ZENEL KABASHI

Mbrojti temën e disertacionit të doktoratës në vitin 1996 po në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas u zgjodh docent, profesor inordinar (1997) për lëndën e mjekësisë interne. Është themelues i shërbimit gastroenterologjik në kuadër të Klinikës Interne të Qendrës Spitalore Universitare. Në vitin 1998 formoi Shoqatën e Gastroenterologëve të Kosovës dhe ishte kryetar i saj. Është autor dhe bashkautor i një numri të konsiderueshëm të punimeve shkencore dhe profesionale të kumtuara në kongrese e simpoziume dhe të publikuara në revista të ndryshme. (Ahmet Brovina)

KAÇAMAKU Misbah (1968-). Pianist. Lindi në Mitrovicë. Pas shkollës së ulët të muzikës në vendlindje, e vazhdoi të mesmen në Prishtinë dhe gjatë kësaj kohe mori vendin e dytë në garat federative të ish-Jugosllavisë dhe përfaqësoi shkollën në festivale e takime të tjera. Studioi në Moskë në Akademinë "Gnjesinij". Specializoi muzikën vjeneze në "J. Haydn Conservatorium" në Eisenstadt (prof. J. McChesney), ndërsa u magjistrua më 2011 në Fakultetin e Muzikës në Shkup (prof. J. Çakar), ku vijoi studimet e doktoratës. Ishte udhëheqës i arteve skenike-muzikore në departamentin e kulturës në Prishtinë dhe aktiv në formimin e Filarmonisë së Kosovës, me të cilin koncerton si solist. Qe bashkëthemelues i Ansambllit "Vivendi", me të cilin koncertoi në Slloveni, Tetovë, Barcelonë. Radhazi mori pjesë në festivalin "Re-Musica" në Prishtinë, si pianist e bashkëpunëtor në promovimin e veprave të kompozitorëve kosovarë. Pjesëmarrës në festivalet "DAM" (Prishtinë), Netët e muzikës klasike (Durrës) etj. Shoqëroi instrumentistët M. Marang, A. Kaimbacher, A. Strazimiri, D. de Willencourt, R. Leleu, Sh. Doli, F. Vlashi etj. Është profesor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. (Indira Çipa)

KAÇANI Jorgaq (1952-). Inxhinier mekanik, profesor, akademik. Lindi në Cerkovinë të Vlorës, Shqipëri. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje dhe në Vlorë, ndërsa studimet për inxhinieri mekanike i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë në Tiranë. Fillimisht punoi si inxhinier në Vlorë (1977-1980), ndërsa më pas emërohet asistent në katedrën e teknologjisë së metaleve të Fakultetit të Inxhinierisë. Më 1988 merr titullin kandidat i shkencave dhe doktor i shkencave më 1994.



JORGAQ KAÇANI

Ushtrroi një sërë funksionesh në institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe atë të dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në periudhën 1996-2007 dhe rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës (2008). Po në këtë vit zgjidhet edhe

anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në periudhën 2008-2011 ishte kryetar i Konferencës së Rektorëve të Republikës së Shqipërisë. Ka kryer kualifikime dhe specializime jashtë shtetit: në Itali, në SHBA, në Britani, në Francë, Portugali, Gjermani, Greqi etj. Është hartues, koordinues dhe drejtues i shumë projekteve kombëtare e ndërkombëtare dhe hartues i disa teksteve mësimore, autor dhe bashkautor i shumë artikujve, referimeve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka dhënë kontribut të veçantë në rritjen e bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës. Për rezultatet në punën shkencore dhe arsimore është nderuar me çmime dhe mirënjohje. (Fejzullah Krasniqi)

KAÇANIKU. Qytezë në jug të Kosovës dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Ndodhet rreth 53 km larg Prishtinës dhe 35 km larg Shkupit. Lartësia mbidetare 474 m. Shtrihet



KAÇANIKU

përgjatë rrjedhës së lumit Nerodime dhe Lepenc, në fillim të grykës së Kaçanikut. Në të dy anët është e mbyllur nga malet e Sharrit dhe të Karadakut. Nëpër Kaçanik kalojnë vija të rëndësishme rrugore dhe hekurudhore, përmes të cilave Kaçaniku lidhet me qendrat e

Kosovës dhe të Maqedonisë. Sipas regjistrimit të vitit 2011 Kaçaniku kishte 10,393 banorë, me dendësi mesatare prej 659 b/km². Është qendër administrative dhe funksionale për 31 vendbanime përreth. Qyteza e Kaçanikut është vendbanim i vjetër. Këtë e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike dhe toponomastike. Si vendbanim njihet që nga viti 1392. Fizionominë urbane filloi ta marrë qysh në shekullin XVI, kur veziri i Tropojës së Lumës, Koxha Sinan pasha ndërtoi Xhaminë, hamamet, mullinjtë, kuzhinën popullore etj. Në vitin 1913 kishte 1,236 banorë, në regjistrimin e vitit 1921 kishte 210 shtëpi me 1,205 banorë, ndërsa në vitin 1948 kishte 2,094 banorë. Aktivitetet kryesore ekonomike janë: bujqësia, tregtia, turizmi dhe industria. Nga objektet e standardit shoqëror ka administratën komunale, postën, qendrën e mjekësisë familjare, shkollën fillore dhe të mesme, shtëpinë e kulturës etj. (Shpend Agaj)

KAÇANIKU (komuna). Komunë në jug të Kosovës, me sipërfaqe 211.4 km². Kufizohet me komunën e Ferizajt në veri, me Vitinë në verilindje, me Shtërpcën në perëndim, me Hanin e Elezit në jug dhe me Maqedoninë në juglindje dhe jugperëndim. Ka pozitë të mirë gjeografike, ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Nëpër territorin e komunës kalojnë rrugë të rëndësishme ndërkombëtare si ajo Prishtinë-Kaçanik-Shkup, Prishtinë-Gllboçicë-Tetovë-Shkup, si dhe lidhja hekurudhore me karakter ndërkombëtar: Prishtinë-Kaçanik-Shkup, e ndërtuar në vitin 1873, segment i hekurudhës ndërkombëtare Athinë-Shkup-Prishtinë-Beograd-Zagreb-Munhen. Gjetjet e shumta arkeologjike, mbetjet e kulturës materiale dhe toponimet dëshmojnë për popullimin e hershëm të kësaj hapësire. Në fshatin Kotlinë janë gjetur gërmadha të vendbanimit të hershëm, armë dhe gjësende të tjera, që datojnë nga shekulli III p.e.s. Disa nga monumentet dhe ngjarjet historike me të cilat identifikohet Kaçaniku me rrethinë janë Kalaja, Xhamia e Sinan Pashës dhe Shpallja e Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator të vitit 1990, e cila ndryshe njihet si “Kushtetuta e Kaçanikut”. Në defterët e Perandorisë Osmane haset si Kaçanikller. Komuna e Kaçanikut ka 31 vendbanime. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit (2011), komuna kishte 33,409 banorë, ndaj 12,836 banorë në vitin 1948. Dendësia mesatare e popullsisë është 158 b/km². Ekonomia e

Kaçanikut është e orientuar në bujqësi dhe në prodhimin e materialit ndërtimor. Kushtet dhe resurset natyrore ofrojnë mundësi për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë dhe turizmit. (Shpend Agaj)

KAÇANIKU Gafurr (1943-). Futbollist, trajner i futbollit. Lindi në Prizren. Nisi karrierën si portier dhe në moshën 16-vjeçare mbrojtja ngjyrat e skuadrës së juniorëve të KF "Liria". Debutoi në vitin 1960 në ekipin e parë të skuadrës. Më pas kaloi në rolin e mesfushorit sulmues. Gjatë karrierës së tij 20-vjeçare zhvilloi rreth 400 ndeshje. Në kampionatin e Kosovës 1969-1970 ishte shënuesi më i mirë i ligës. Pas periudhës aktive si futbollist, u bë trajner. Në vitin 1983 u diplomua në Shkollën e Trajnerëve të Entit të Kulturës Fizike të Kosovës. Në vitin 1985 u pajis me licencën e trajnerit të ekipit të të rriturve dhe menjëherë u emërua në postin e kryetrajnerit të KF "Liria". Është autor i librit "Portieri në lojën e futbollit" dhe të një monografie për KF "Liria". (Vllaznim Bytyçi)

KAÇANIKU I VJETËR. Fshat në komunën e Kaçanikut, 9 km në veri të qytetit. Shtrihet përgjatë rrugës magjistrale Kaçanik-Prishtinë dhe asaj rajonale Kaçanik-Kaçanik i Vjetër-Viti. Lartësia mbidetare 400-700 m. Është vendbanim i tipit të dendur. Nëpër territorin e fshatit rrjedh lumi Nerodime. Sipërfaqja është 9.9 km². Është vendbanimi i vjetër. Këtë e dëshmojnë gjurmët e kulturës materiale, toponimet dhe gjetjet e shumta arkeologjike. Është i regjistruar në një hartë të vjetër austriake të vitit 1689. Në vitin 1905 Kaçaniku i Vjetër kishte 46 shtëpi shqiptare. Sipas regjistrimit të fundit (2011), kishte 1,940 banorë, ndaj 635 banorë në vitin 1948. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik i popullsisë. (Shpend Agaj)

KAÇANIKU Mehmet Pashë (?-1609). Udhëheqës i shquar ushtarak, serdar, bejlerbe, vali i Perandorisë Osmane. I njohur edhe si Mehmet Pashë Kaçanikliu, sipas vendlindjes së tij. Rrjedh nga një familje shqiptare me origjinë nga Topojani i Lumës. Ishte i biri i sadriazemit Koxha Sinan Pashës. Ka mbajtur pozita të ndryshme në Perandorisë Osmane. Në vitin 1590 përmendet si aga i jeniçerëve, kurse në vitin 1592 u bë bejlerbej i Rumelisë. Në këtë detyrë e kishte emëruar babai, i cili asokohe ishte Vezir i Madh. Një vit më vonë,

ai u bë vali i Sirisë, kurse nga viti 1593 u bë serdar me gradën vezir. Më pastaj mori postin e komandantit të Kalasë së Beogradit, vali i Konjës dhe i Damaskut. Sipas kronistëve, Mehmet Pasha, përveç përkrahjes nga babai, ka pasur edhe përkrahjen e oborrit perandorak, sepse ka qenë i martuar me motrën e sulltan Selimit II, princshën Xhemile. Njësoj si i ati, në Kaçanik ndërtoi disa objekte: një xhami, një shkollë, një bibliotekë dhe një teqe në Shkup, pastaj një xhami dhe një mejtep në Gostivar etj. Originali i tri vakëfnameve të Mehmet Pashë Kaçanikut ruhet në Arkivin e Kosovës, është i shkruar në osmanishte dhe ka gjithsej 65 faqe. (Sadik Mehmeti)

KAÇANIKU Shukri (1951-). Xhirues, drejtor i fotografisë. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studioi për kamerë në Akademinë e Filmit në Beograd dhe në Institutin e Filmit në Oslo. Ishte fotoreporter, ndërsa bashkëpunoi me revista dhe gazeta të njohura në ish-Jugosllavi. Një kohë punoi në Televizionin e Beogradit, në redaksinë në gjuhën shqipe, ku xhiron dokumentarët "Kullat e Junikut", "Duart e arta" etj. Në Televizionin e Prishtinës xhiron emisione dhe reportazhe, emisione dokumentare dhe filma e drama televizive, pastaj seriale dhe filmat televizivë "Klubi i vetëvrasësve", "E kafshoja terrin", "Kopshti i pleqërisë", "Binarët", "Pehlivanët, "Një jetë e tërë". Punoi edhe në projektet e "Kosovafilmit": "Loja e rufaive", "Kur pranvera xhirohet", "Era e Lisi, "Tepricat" etj. Në periudhën 1991-2006 punoi në "Nordisk Film" në Oslo, ku realizoi filmin e shkurtër "Language-Sproket", dokumentarin "Parkens luft", "Karakol", "God morgen Oslo". Nga filmat e metrazhit të gjatë, ku ishte drejtor artistik, veçohen: "Etjet e Kosovës" (2006), "Kodi i jetës" (2012), "Gomarët e kufirit" (2009), "Anatema" (2006). (Gani Mehmetaj)

KAÇANIKUT (E FOLMJA E). Bën pjesë në grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore. Nuk paraqet ndonjë areal me strukturë gjuhësore unike, pasi ngjason me të folmet e tjera të këtij nëndialekti. Dallimet dialektore dalin në fushë të fonetikës e të morfologjisë. Fonema *y* ruhet në të folmen e qytetit, ndërsa në të folmet e fshatrave ka kaluar në *i*. Ruhen grupet e vjetra *vo* dhe *oe*. Fonema *nj* del vetëm në pozicionin nistor, kurse në mes të fjalës ka


dhënë *n* dhe në pozicionin final zëvendësohet me fonemën *j*. Sonantja *j* mungon në shumicën e fjalëve me prejardhje nga gjuhët orientale, ndërsa del në fjalë të tipit: *lajtëm, krujtëm*. Ruhët kundërvënia midis fonemave *r-R*, ndërsa nga grupet e bashkëtingëlloreve pjesërisht ruhet grupi *ng*, ndërkohë që grupet *tj* dhe *dj* kanë dhënë nga dy reflekse: *tj-k* (*tjetër-ketër*) dhe *tj-g* (*atje-age*), ndërsa *dj* ka dhënë *gj*: *djeg-gjeg, djalë-gja:l* dhe *djep-gjep*. Dallimet në fushë të morfologjisë dalin posaçërisht në sistemin përemëror. Veta e tretë e përemrit vector *ai* (*aj*) shumësin e bën si përemri i gjinisë femërore *ato*, që do të thotë se në këtë të folme mungon shumësi mashkullor *ata*. Përemri dëftor *ky* realizohet si *ki*, ndërkohë që mungon trajta e shumësit për gjininë mashkullore. Në vend të saj përdoret trajta e gjinisë femërore *kto*. Foljet e diatezës pësore marrin mbaresa të ndryshme nga ato të arealeve të tjera gege, si: *une lãna, une hekna*, ndërsa veta e dytë dhe e tretë njëjës e shumë marrin mbaresat: *-hësh, -hët* dhe *-hni, -hën*, p.sh. *ti lãhësh, ju lãhni*. Mënyra kushtore të tashmen e bën: *dët punojshnja* dhe të kryerën: *dët kisha punu*. Foljet e zgjedhimit të dytë dalin me një pjesore të zgjeruar, sidomos në mënyrat e pashtjelluara, si: *shitën, shatitën, kërshitën*. Këto ndryshime dialektore përligjen me pozitën skajore të saj, si dhe me ndikimin e të folmeve shqipe të Maqedonisë, posaçërisht të folmes së qytetit të Shkupit dhe të Tetovës. (Haki Hysenaj)

KAÇAPOR Sait (1947-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Orlje, Tutin, ku mori edhe arsimin fillor. Kreu Shkollën Normale në Novi Pazar dhe Akademinë Pedagogjike në Svetozarevë (Serbi). Studioi pedagogjinë në Universitetin e Zagrebit, ku edhe magjistroi më 1983, ndërsa doktoroi në Universitetin e Beogradit më 1991. Ishte mësimdhënës i gjuhës serbokroate në degën e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës (1991-2001), pastaj në Universitetin e Mostarit, ndërsa në Universitetin e Sarajevës ishte koordinator i një projekti ndërkombëtar (2002-2009). Fushat e interesimit shkencor dhe profesional të S. Kaçaporit janë pedagogjia e përgjithshme, historia e pedagogjisë, pedagogjia shkollore etj. Është autor i shumë kumtesave dhe studimeve shkencore-profesionale dhe i disa veprave të veçanta: “Shkollimi në Novi-Pazar me rrethinë

1918-1941” (1987), “Hyrje në pedagogjinë shkollore” (1999) etj. (Demë Hoti)

KAÇIKU Ahmet (1964-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Biti të Epërme të Shtërpcës. Emigroi në Gjermani, ku u mor edhe me veprimtari politike. Në maj të vitit 1988 u kthye në Kosovë. Ishte themelues dhe komandoi pikën e UÇK-së në Rokopec të Maçitevës, në kuadër të Zonës Operative të Pashtrikut. Në tetor të po atij viti u bashkua Zonës Operative të Nerodimes (ZON), ndërsa në nëntor u emërua komandant i Brigadës 161 të kësaj zone. Ishte pjesëmarrës në disa beteja të zhvilluara në mes të UÇK-së dhe forcave serbe përgjatë vijës së frontit Shtërpcë-Ferizaj-Shtime-grykë e Carralevës. Në fshatin Reçak në janar të vitit 1999 mori pjesë në luftimet e zhvilluara për mbrojtjen e kufomave të masakrës së Reçakut. Më 19 janar 1999 u vra në afërsi të fshatit Reçak. (Ruzhdi Jashari)

KAÇINARI Gjergj (1945-). Kompozitor, dirigjent. Lindi në Prizren. Shkollën e ulët dhe të mesme të muzikës i kreu në vendlindje. Kreu Shkollën e Mesme Instrumentale për violinë dhe shkollën e parë në Akademinë e Muzikës në Beograd, ndërsa shkollën II në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, drejtimi teorik-pedagogjik. Punoi në Radiotelevizionin e Prishtinës si bashkëpunëtor dhe producent muzikor.



GJERGJ KAÇINARI

Njihet si kompozitor i muzikës së lehtë, popullore, për fëmijë dhe i asaj korale. Nga viti 1985 ishte udhëheqës-dirigjent i Korit “Colegium Cantorum” të Prishtinës. Është themelues i oktetit të burrave “Bandillët e Kosovës” dhe i oktetit “Kosovarët”. Anëtar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës nga viti 1975. Ka kompozuar këngë të zhanreve të ndryshme. Më të njohurat janë: “Arabela”, “Syri yt ai qiell me shi”, “Sa fort të dashuroj”, “Këngë gishtore”, “Nëna më ka ble një kukull”, “Lules sime” etj. Më 1995 botoi librin “Margaritarët e këngëve popullore”. Mori pjesë në shumë festivale muzikore. Më 1972 fitoi “Okarinën e artë” në festivalin “Akor-det e Kosovës”. (Xhevdet Gashi)

KAÇINARI Mark (1935-1985). Kompozitor, pedagog i muzikës. Lindi në Prizren. Pasi kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, studioi në drejtimin teoriko-pedagogjik të Akademi-



MARK KAÇINARI

misë së Muzikës në Beograd. Me t'u diplomuar u kthye në Prizren, si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Muzikës, njëherësh drejtues i korit të Shoqërisë kulturore-artistike "Agimi" të Prizrenit. Pas kalimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, dega e edukimit muzikor, themeloi dhe drejtoi Korin "Collegium cantorum". Me të u paraqit me sukses në festivale, gara, manifestime muzikore brenda dhe jashtë Kosovës. Me këtë kor ka arritur suksese dhe ka marrë edhe çmime ndërkombëtare (Langolen, Angli). Nga viti 1975 deri në vdekjen e hershme ishte profesor i solfezhit. Qysh si pedagog në Prizren filloi të përpunojë dhe të kompozojë këngë korale ("Zogu i Ohrit", suita "Shamikuqja", "Bijtë e shqipes" etj.), pjesë pianistike ("Duart e vogla", "Elegjia", "Suita iliriane" etj.), romancat për zë e piano ("Buzë lumit ke shtëpinë", "Para pasqyrës") dhe këngë për pionierë, por dhe të studiojë kompozimin në Shkup. (Zeqirja Ballata)

KAÇINARI-MIKULA Rina (1974-). Violonçelite. Lindi në Prishtinë. Kreu Shkollën e Ulët të Muzikës po në Prishtinë, të mesmen në Zagreb. Studioi për violonçel në Akademinë e Muzikës në Zagreb dhe u diplomua në Grac (Austri), ku më pas u magjistrua në drejtimin koncertal dhe atë pedagogjik. Studioi për xhaz, kompozim e aranzhim për instrumente harkore në Universitetin "Bruckner" në Linc. Qe angazhuar si violonçelite në Teatrin e Operës dhe Baletit Slloven në Maribor, më pas mbajti koncerte në SHBA, Kanadë, Meksikë, Turqi, në Europë, ish-Jugosllavi, Kosovë e Shqipëri. Shquhet te duoja Catch-Pop String-Strong, themeluar më 2007 në Vjenë me violisten J. Poprzhnan, e zgjedhur nga Ministria për Europë e Austrisë të përfaqësojë muzikën e saj. Është fituese e garave



RINA KAÇINARI-MIKULA

në Festivalin uzbek "Sharq Taronalari", "Fraunhofer Volks musik wett bewerb" në Munih dhe "Austrian World Music Advancement Award". Nga viti 2012 është pedagoge e violonçelit dhe e muzikës kamerale në SONUS, Kärnten (Austri) dhe në Akademinë e Muzikës Popullore Lesechtall (Austri). Merret me produksione teatrale si violonçelite, aranzhere e artiste. Ka incizuar disa disqe. Jeton dhe vepron në Vjenë. (Arnisa Rexhepi)

KAÇIU Skënder (1962-). Agronom, profesor universiteti. Lindi në Lupç të Poshtëm të Podujevës, shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe të mesmen në Podujevë. Kreu Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit (1990). Tezën e doktoratës nga shkencat bujqësore e mbrojti në Universitetin e Prishtinës (1999). Zgjidhet asistent në lëndën e perimtarisë dhe si ligjërues i kësaj lënde i ka arritur të gjitha gradat universitare. Për qëllime specializimi nga fusha e perimtarisë ka qëndruar në Austri, SHBA dhe Hungari. Ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në disa projekte shkencore-hulumtuese, në bashkëpunim me universitete të vendeve të tjera. Është autor dhe bashkautor i punimeve shkencore-profesionale, i teksteve për shkollat e mesme profesionale dhe i teksteve universitare ("Serrat dhe shfrytëzimi i tyre", bashkautor; "Kultivimi i perimeve në mjedise të mbrojtura"). (Latif Susuri)



SKËNDER KAÇIU

KADA Besnik (1970-). Gazetar. Lindi në Lubozhdë të Istogut. Arsimin bazë e mori në vendlindje, studimet për drejtësi i kreu në Prishtinë dhe ato për gazetari në Tiranë. Gjatë viteve '90 bashkëpunoi më gazetën studentore "Bota e re" dhe me Televizionin Shqiptar (TVSH), në redaksinë e programit për Kosovën. Në luftën e Kosovës ishte njëri nga reporterët që ndoqi zhvillimet në fushëbetejë përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri, duke raportuar për TVSH-në dhe duke shoqëruar reporterët e medieve botërore. Pas luftës mbuloi sektorin e informimit në institucione të ndryshme, në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, në Ministrinë

e Mbrojtjes, në Ministrinë e Brendshme, në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave etj. Punoi edhe gazetar-redaktor në gazetën “Bota sot” dhe korrespondent-bashkëpunëtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH). Është zyrtar për informim në Bankën Qendrore të Kosovës. (Ibrahim Berisha)

KADA Xhemajl (1912-1938). Veprimtar i lëvizjes antifashiste, pjesëmarrës i Luftës së Spanjës, Hero i Popullit. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe një pjesë të shkollës së mesme. Në qytetin e lindjes mori edhe idetë e para komuniste. Më 1928 kalon ilegalisht në Shqipëri. Qëndroi disa muaj në Tiranë dhe më pas vazhdoi studimet në shkollën ushtarake të Torinos. Pas kthimit në Shqipëri, me ndihmën e Asim Vokshit u punësua si oficer në Tiranë. Këtu bie në kontakt me grupet komuniste. Mori pjesë në Kryengritjen e Fierit (1935), me shumë veprimtarë antifashistë. Si pjesëmarrës i kryengritjes u burgos dhe më pas u lirua pas amnistisë. Më 1936 shkoi në Spanjë, për t’u rreshtuar në Brigadën e 12-të ndërkombëtare “Garibaldi”. U dallua si xhenier i shquar, që krijoi ura false mbi lumin Ebro. Në pranverën e vitit 1938 plagoset, dërgohet në Paris për mjekim dhe, pas shërimit, kthehet sërish në vijën e frontit në Ebro, për të penguar depërtimin e frankistëve në Valencia. Duke aftësuar një urë në lumin Moro, plagoset rëndë dhe vdes në spitalin e Barcelonës. Në Shqipëri u shpall Hero i Popullit. (Kosovar Basha)

KADIANIZMI. Lëvizje islame që u shfaq në Indi. Sekti u formua nga Mirza Gulam Ahmedi (vdiq më 1908), nga qyteza Kadijan në Penxhab. Kadianizmi dhe krahu i tij ahmedizmi kishte si burim sunizmin. Fillimisht sekti u shfaq si reaksion kundrejt aktivitetit misionarist anglez në Indi. Ndërkaq, ahmedizmi është krah i kadianizmit, të cilin e themeloi Mirza Mahmud Ahmedi (vdiq më 1954). Ata i dallonte nga kadijanijtë edhe selia, e cila nga Kadijani u bart në Lahore. Në Kosovë Vushtrria, është përballur me këtë sekt qysh në vitin 1937, kur dr. Muhammed Din, misionar ahmedit, mbajti disa ligjërata. Imami i xhamisë dhe xhemati e vërejtën këtë dhe e larguan. Edhe në vitet ‘80 të shek. XX studenti ahmedit në Prishtinë, Muhamed Zekerija Kan e përktheu Kuranin shqip, duke i ruajtur shpjegimet ahmedite. Viteve të fundit ata janë aktivë edhe

në hapësirat shqiptare dhe janë mjaft agresivë. (Nexhat Ibrahim)

KADIRIZMI. Rrugë mistike islame, e themeluar nga Abdulkadir Gejlaniu (vdiq më 1166). Abdulkadir Gejlaniu lindi në qytetin Gilan në jugperëndim të detit Kaspik. Ishte autor i njohur i letërsisë dhe i mistikës islame dhe konsiderohej se rridhte prej familjes së profetit Muhamed. Tarikati Kadiri në viset e Anadollisë depërtoi nga mesi i shekullit XV, nëpërmjet Eshrefoglu Abdullah Rumiut (vdiq më 1469), ndërsa në Stamboll dhe në Ballkan depërtoi në shekullin XVII, nëpërmjet Ismail Rumiut (vdiq më 1632). Në viset shqiptare, kadirizmi më së tepërmi ishte i përhapur në Kosovë. U shfaq nga mesi i shekullit XVII dhe u përhap në shekujt XVIII dhe XIX. Teqeja e parë dhe më e vjetër kadirije në Kosovë është Teqeja e sheh Hasan Efendiut në Prizren. Teqe të kadirinjve ka edhe në Gjakovë, Mitrovicë, Rahovec, Prishtinë dhe Vushtrri. Konsiderohet se kadirizmi dhe teqetë e këtij tarikati kanë ndikuar edhe në edukimin dhe ngritjen arsimore të popullatës shqiptare. (Metin Izeti)

KADOLLI Ilaz (1959-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), avokat. Lindi në Bukosh të Suharekës. Më 1984 kreu Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Ishte njëri nga themeluesit e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK) në vitin 1982 dhe anëtar i kryesisë së LPK-së brenda vendit në periudhën 1982-1999. Ishte pjesëmarrës në mbledhjet e përgjithshme të LPK-së brenda vendit në Prapashticë të Prishtinës (1989), në Divjakë të Kleçkës (1989), në Ujëmir të Drenicës (1991) dhe në Kollare të Maqedonisë (1993). U burgos më 2 korrik 1993 dhe u dënua me 2.5 vjet burg. Ishte themelues i njësiteve guerile të organizuara nga LPK-ja dhe njëri ndër themeluesit e celulave të para të UÇK-së. Gjithashtu ishte ndër themeluesit kryesorë të Brigadës 123 të Zonës Operative të Pashtrikut, ku u emërua në detyrën e komandantit për moral dhe politikë, pastaj themelues dhe udhëheqës i njësisë speciale diversante “Syri i Shqiponjës”. Pas çlirimit të vendit ushtroi detyra me përgjegjësi në institucionet e vendit. Nga viti 2003 ushtroi profesionin e avokatit në Prizren. (Ruzhdi Jashari)

KADRIJA Sulejman (1936-). Piktur. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor në vendlindje,

Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Zagreb (1964). Më 1979, me bursën e qeverisë frënge kreu një specializim në Paris. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK) nga viti 1965. Hapi ekspozita vetjake në Gjakovë (1959), Pejë (1959), Mitrovicë, Shkup (1961), Prishtinë (1965) dhe mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta në Zagreb, Sarajevë, Beograd, Tuzëll, Suboticë, Banjallukë, pastaj në Gjakovë, me rastin e 100-vjetorit të shtetit shqiptar etj. Nga viti 1965 mori pjesë në Sallonin Pranveror, ekspozitën vjeshtore dhe në Bienalen e Vizatimit, organizuar nga SHAFK-u. Është laureat i çmimit për pikturë i SHAFK-ut më 1976 dhe 1986. Në vitin 2000 iu nda mirënjohja e SHAFK-ut dhe e Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës. Pas hulumtimeve eksperimentuese dhe lëkundjeve të herahershme në botën artistike e figurative filloi t'i bashkohet lëvizjeve moderniste, duke krijuar në frymën e ekspresionizmit abstrakt. (Tahir Emra)

KADRIU Flora (1966-). Aktore. Lindi në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Kreu studimet në Fakultetin Pedagogjik në Shkup (2005). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë, ndërsa studimet e doktoratës në shkencat politike në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shkupit (2012). Nga viti 1989 është anëtare e ansambllit të Teatrit Shqiptar në Shkup. Luajti një mori rolesh, nga të cilat veçohen në shfaqjet: “Kush e solli Doruntinën”, “Antigona”, “Mbreti Lir”, “Përbindëshi”, “Pas vdekjes”, “Hijesina” etj. Luajti gjithashtu edhe në disa filma, drama dhe seriale televizive. Nga viti 2005 ushtroi funksione të ndryshme politike në institucionet e Republikës së Maqedonisë. Në periudhën 2006-2011 ishte deputete në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. (Kushtrim Bekteshi)

KADRIU Hasan (1958-1998). Menaxher sportiv. Lindi në Preshevë. Ishte menaxheri i parë shqiptar në kuadër të FIFA-s, që lobi për anëtarësimin e Kosovës në FIFA. Kreu studimet në fushën e të drejtës ndërkombëtare në Friburg të Zvicrës dhe më pas u angazhua për avancimin e sportit kosovar. Bëri një punë të madhe për ndërkombëtarizimin e vlerave të futbollistëve tanë më të shquar, duke i licencuar

ata në skuadrat e njohura ballkanike dhe europiane, në rrugë ligjore dhe institucionale. Humbi jetën në rrethana tragjike në Bullgari. (Albatrit Matoshi)

KADRIU Ibrahim (1945-). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Zhegër të Karadakut, ku kreu shkollën fillore. Mbaroi Shkollën Normale në Gjilan, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe



IBRAHIM KADRIU

i mbaroi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Në fillim punoi si mësues, ndërsa më pas punoi si gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën “Rilindja”, një kohë në Sekretariatit e Informatave të Kosovës, kryeredaktor i revistës “Hareja” dhe pas luftës në Kosovë, redaktor i rubrikës së kulturës në gazetën “Zëri”. Ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Vepra e tij letrare, sidomos ajo romanore përfshin tematikën e jetës së njeriut në ambientin autokton, në kohë dhe periudha të ndryshme historike. Është pjesëmarrës i takimeve të ndryshme letrare kombëtare e ndërkombëtare dhe laureat i shumë mirënjohjeve dhe çmimeve letrare, si i çmimit “Pjetër Bogdani” (2007), “Ymer Elshani” (2007), “Beqir Musliu” (2011), çmimit “Azem Shkreli” për roman (2013) etj. Vepra të tij letrare (romane dhe vëllime me poezi) u përkthyen edhe në gjuhë të huaja. U prezantua në antologji dhe panorama të letërsisë sonë, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të tjera. Veprat e botuara nga fusha e poezisë për të rritur: “Netët e Karadakut” (1969), “Diçka po ndodh” (1972), “Hapësirë” (1977), “Troku”, (1980), “Pastaj harrohet” (1989), “Frymëmarrje në shtjellë” 2007 etj.; pastaj romanet: “Pas kthimit” (1975), “Kohë e të korrave” (1979), “Kroi i ilaçit”, (1982), “Qerrja e dritës” (1990), “Loja e fundit” (1993), “Vite me plagë” (1998), “Shtëpia e fantazmave” (2004), “Çuni i kohës së Lekës” (2006), “Kalorësi i Karadakut” (2007), “Në Vajhall” (2008), “Gloria në mes” 2010, “Gjallori” (2012), “Pjella e dreqit” (2012), “Kapërcimi i ujit të madh” (2014) etj. Është lauret i një sërë çmimesh letare dhe mirënjohjesh. (Xhevat Sylja)

KADRIU Lirijon (1973-). Dizajner. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për dizajn grafik në

Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1998), ndërsa studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin e Artit dhe të Dizajnit “ESBA” në Gjenevë (1999-2001). Ishte drejtor kreativ i revistës për fëmijë “Hareja” (1995-1998) e “Dardania Design” në Prishtinë (1993-1995) dhe redaktor artistik në të përditshmet “Koha ditore” dhe “Zëri” (1998-2000). Punoi në menaxhimin e fushatave qeveritare dhe joqeveritare, komerciale e politike (“Letra System” Gjenevë, 2000; Advertising Studio D-line, Prishtinë 2001; VM3, Prishtinë 2006; KIVO, Prishtinë 2013). Realizoi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në ekspozita kolektive në Kosovë dhe jashtë. Është fitues i çmimeve: Dizajneri i Vitit, Salloni i Nëntorit SHAFK-SHAAK, 1998, 2002; Logo “Posta e Kosovës”, 2004; Logo/Brend “Telekomi i Kosovës” 2005; European Logo Design Awards “EULDA ‘06”, Milano, 2006 etj. (Zeni Balazhi)

KADRIU Margarita (1973-). Gazetare. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studioi për ekonomi e menaxhment në Austri. Në vitin 1997 u kthye në Prishtinë dhe filloi botimin e revistës së përmuajshme “Elita” dhe gazetën e përditshme “Kosova sot”, gazetë në të cilën punoi afro 17 vjet, në cilësinë e drejtores dhe kryeredaktores së gazetës. Po ashtu, nga viti 1999 deri në vitin 2014 udhëhoqi edhe “Top Kosova Radio”. Në vitin 2007 u zgjodh “Biznesmenia më e mirë në Kosovë”. Në vitin 2013 u bë nënkryetare e Partisë Demokratike të Kosovës dhe mori mandatin e deputetes në legjislaturën e pestë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. (Artan Krasniqi)

KADRIU Sejduallah (1957-). Veprimtar, ish-iburgosur politik. Lindi në fshatin Ramnabuqë të Bujanocit. Kreu shkollën e mesme në Bujanoc, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës në fshatin Zarbincë të Bujanocit. Që në kohën e studimeve u përfshi në aktivitetet ilegale. U arrestua në vitin 1983 dhe u dënua me 6 vjet burg. Gjatë viteve 1993-1995 udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Bujanoc, kurse në vitet 1995-1998 udhëhoqi “Fondin solidar”. Nëpërmjet këtij fondi u mblodhën ndihma materiale për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për popullsinë në zonat e luftës

në Kosovë. Gjatë luftës në Luginën e Preshevës (2000-2001) ishte anëtar i Këshillit Politik për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. (Fehari Ramadani)

KADRIU-KULINXHA Lumnije (1970-). Etnologe. Lindi në Prishtinë. Arsimitin bazë e mori në vendlindje, ndërsa studimet për etnologji dhe gjuhësi të përgjithshme i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit (1994). Nga viti 1996 punon në degën e etnologjisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Gjatë viteve 2001-2002 vijoi specializimin nga fusha e antropologjisë sociale në Universitetin “York” në Toronto të Kanadasë. Në vitin 2009 mbaroi studimet master për etnologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nga fusha e etnologjisë dhe antropologjisë kulturore botoi një sërë punimesh shkencore lidhur me identitetin dhe kozmopolitizmin, me aspekte etnokulturore të globalizmit etj. Nga kjo fushë botoi edhe studimin monografik “Glokalizimi - Perceptime etnokulturore” (2009), ndërsa përktheu në shqip librin e antropologut Alan Barnard “Historia dhe teoria e antropologjisë” (2011). Ka marrë pjesë në simpoziume e konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Angelina Hamza)

KAJDOMÇAJ Hysen (1943-). Politikan. Si i ri ishte aktivist i organizatës së rinisë. Një kohë ishte përfaqësues i Kosovës edhe në Beograd, në Kryesinë e Lidhjes së Rinisë së Serbisë. Në Prishtinë një kohë punoi në Kryesinë e Lidhjes së Sindikatave të Kosovës. Në vitin 1989, pas skadimit të mandatit njëvjeçar të Remzi Kolgecit, u zgjodh kryetar i Kryesisë së Kosovës, ku qëndroi deri në suprimimin formal të Kushtetutës së Kosovës. Në kohën e konflikteve në mes së Kryesisë së Kosovës e asaj të Serbisë dhe disa pjesëtarëve të Kryesisë së Federatës Jugosllave, të përqendruar në Beograd, më 27 qershor 1989 u emërua në postin e kryetarit të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK). Me suprimimin e autonomisë, H. Kajdomçaj u shkarkua nga ky post, duke mbetur kryetari i fundit i Kuvendit të KSA të Kosovës. (Ali Cenaj)

KAJEVIQ (Kajević) Fehim (1945-). Poet boshnjak nga Kosova, kritik letrar, publicist. Lindi në fshatin Shipovicë afër Bijelo Poljes, në Mal të Zi. Kreu studimet e gjuhës dhe letërsisë

serbokroate në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme në Kosovë, më pas si gazetar dhe redaktor i gazetave në Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Mal të Zi. U përfshi në shumë antologji të poezisë dhe u përkthye në disa gjuhë. Përveç poezisë, shkruan dhe boton prozë dhe kritikë letrare. Gjithashtu merret edhe me publicistikë. Botoi veprat: “Të jesh i vdekur” (1971), “Mrekullitë” (1975), “Fluturuesi” (1976), “Kufiri” (1981), “Pompei” (1980), “Sirius” (1993), “Hyrja në rreth” (2004), “Largimi i vdekjes” (2007), “Kornizë nga lëkura e gjarprit” (2007). Jeton dhe punon në Sarajevë. (Ismet Markoviq)

KAJMAKÇIU Aqif (1920-1986). Karikaturist. Lindi në Prizren. Mësimet e para i mori në vendlindje, shkollën fillore e përfundoi në Shtip të Maqedonisë. Më 1938 shkoi në Beograd dhe më pas fillon të botojë karikatura në gazetën humoristike-satirike të Beogradit “Jezh” (Iriqi). Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore kthehet në Prizren. Kur nisi botimi i “Rilindjes”, bashkëpunoi me të, kurse me daljen e saj gazetë e përditshme u pranua karikaturist i rregullt. Vite me radhë përgatiste faqen e përjavshme humoristike-satirike “Anza” të “Rilindjes”. Është karikaturisti i parë në Kosovë. Botoi karikatura edhe me pseudonimin Matrapazi. U pensionua më 1985. (Zenun Çelaj)

KAJTAZI Adriatik (1987-). Volejballist. Lindi në Prishtinë. Karrierën sportive e nisi fillimisht në futboll. Që në moshën 15-vjeçare u paraqit në përbërjen e parë të seniorëve. Gjatë kohës sa luajti për “Mabeteksin” e Prishtinës (2005-2006), fitoi titullin dhe Kupën e Kosovës. Po këtë edicion fitoi edhe titullin e kampionit mbarëkombëtar Si anëtar i po kësaj skuadre, por me emrin e ri “Prishtina”, mori titullin e kampionit dhe të fituesit të Kupës së Kosovës. Në sezonin 2008/09 kaloi te “Studenti” i Tiranës. Me këtë skuadër fitoi titullin dhe Kupën e Shqipërisë. Pas kësaj, dy vjet luajti në Zvicër, në skuadrën “Pallavalo Lugano”. Me këtë skuadër luajti në finale të Kupës së Zvicrës dhe dolën fitues të medaljes së argjendtë. Karrierën e vazhdoi në elitën e volejballit të Maqedonisë (2010-2012), ku me “Shkëndijën” e Tetovës doli kampion dhe fitues i kupës, për të fituar një vit më vonë edhe superkupën mbarëkombëtare (2012), si dhe medaljen e bronzit në Kupën Ballkanike,

që u mbajt në Kluj (Cluj) të Rumanisë (2012). Gjatë viteve 2011-2014 luajti për anëtarin e Superligës nga Doha e Katarit “Qatar Sports Club”. Në vitin 2014 u kthye sërish në Shqipëri dhe me “Studentin” e Tiranës fitoi titullin dhe Kupën e Shqipërisë. Që nga viti 2008 është anëtar standard i kombëtares shqiptare. (Gani Kosumi)

KAJTAZI Arsim (1958-). Shkrimtar, piktor dhe publicist. Lindi në Vitak të Mitrovicës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, ndërsa të mesmin në Prishtinë. Mbaroi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Në periudhën 1982-1993 punoi si gazetar i javores “Zëri i rinisë”. I përkushtuar ndaj pikturës, më 1987 u anëtarësua në Shoqatën e Artistëve Figurativë të Kosovës. Është autor i disa librave letrare: “Prani rrezore”, poezi (1985), “Shakullina”, roman (1990), “Të vdekurit vallëzojnë”, poezi (1993), “Duke krijuar vetveten”, poezi (1999), “Nëntë lëkurat e gjarprit”, roman (2005). Gjithashtu hapi dhjetëra ekspozita personale dhe mori pjesë edhe në disa të tjera të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. (Agron Gashi)

KAJTAZI Elbenita (1992-). Soprano. Lindi në Mitrovicë. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në vendlindje (2009), studimet universitare për solokëndim në Fakultetin e Arteve. Ishte anëtare e korit të Filarmonisë së Kosovës. Aktivitetin interpretues e vazhdoi në skena vendore dhe ndërkombëtare. Disa nga rolet e saj janë: Violeta nga opera “Traviata”, Marulja nga “Dasma arbëreshe”, Mimi nga “La Boheme” etj. Është pjesëmarrëse e garave të ndryshme, në të cilat pati suksese të mëdha: fituese e vendit të parë në Festivalin e Këngës së Flamurit (2012), çmimi special i jurisë, bursë për master-klasë me M. Sighele (2012, 2013), në garat ndërkombëtare “Ricardo Zandonai”, si dhe çmimi i parë në garat ndërkombëtare “ARS Kosova”, Prishtinë (2009). Aktualisht është soliste e korit të Filarmonisë së Kosovës dhe në Operën e Berlinit. (Reze Kryeziu-Breznica)

KAJTAZI H. Besim (1961-). Gazetar. Lindi në Vitak të Drenicës. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Prishtinë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të

Prishtinës (1986). Nga viti 1987 nis të punojë gazetar në të përditshmen “Rilindja”, punë që e vazhdoi edhe pas luftës, deri më 2001. Në vitet 2001-2005 ishte botues dhe redaktor përgjegjës i gazetës javore sportive “Kosova sport”. Gjatë kësaj periudhe punoi redaktor edhe në revistën “Arena sport”, kurse më pas, në periudhën 2006-2010, ishte redaktor në të përditshmen “Infopress” dhe “Sport”. Në vitet 2010-2011 ishte zëvendëskryeredaktor i të përditshmes sportive “Topi” dhe redaktor në të përditshmen “Zëri”. Në vitin 1991 në revistën “Ora” botoi fejttonin “Gjurmëve të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar”. Që nga viti 2012, punon në drejtorinë e shërbimit të gjuhëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. (Veli Bytyçi)

KAJTAZI Halil (1935-). Mbledhës dhe botues i folklorit, shkrimtar. Lindi në Vitak të Drenicës. Kreu arsimin fillor në vendlindje, Shkollën Normale dhe studimet për letërsi në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Prishtinës. Punoi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në Runikë (Skënderaj), në Rakosh (Istog) dhe më pas gazetar i Radio-Prishtinës dhe i gazetës së kombinatit “Kosova” të Obiliqit. Ka vjelë dhe botuar materiale të ndryshme folklorike. Ka botuar përmbledhjet: “Xingli-mingli” (1967), “Nina-nëna” (1978), “Nga lirika popullore e Drenicës” (1972), “Proza popullore e Drenicës” (në pesë vëllime, 1986-2010). Ka shkruar edhe prozë tregimtare dhe romane: “I treti” (1979), “Në shtëpinë e bardhë” (1967), “Pelivan Guri” (2002), “Loti në tri kohë” (2002), “Norka” (2003), “Orët e mëngjesit” (2005), “Udha e eshrave” (2011), “Koha e gjarpinjve” (2013) etj. Është marrë edhe me mjekësinë popullore dhe ka botuar disa broshura nga kjo fushë. (Adem Zejnullahu)

KAJTAZI Mehmet (1944-2003). Shkrimtar, gazetar. Lindi në Kllodernicë të Skënderajt. Kreu shkollën fillore në vendlindje dhe Runik, Normalen në Prishtinë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren. Një kohë punoi si arsimtar i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në vendlindje dhe në fshatra të tjera të Skënderajt, ndërsa prej vitit 1973 ishte gazetar në gazetën e përditshme “Rilindja”. Së fundi punoi si redaktor i prozës në Ndërmarrjen Botuese “Rilindja”. Në lëmin e gazetarisë më së shumti lëvroi reportazhin. Me krijimtari letrare u mor që herët. Ka shkruar romane, tregime, novela.

Veprat e botuara: “Nata në gur” (1984), “Plaku dhe urat” (1986), “Zemër e thyer” (1987), “Fundi i legjendave” (1990), “Shqiptarët në Goli Otok” (1991), “Kodra e Pajtimit” (1993), “Ushtimë e Alboderit” (1993), “Shote Galica” (1995), “Minatorët” (1995), “Thikë në portokall” (1995), “Gjeli i katedrales” (1996), “Santa Ana” (1998), “Guri i dallëndyshes” (1998), “Lindja në qiell” (2000), “Ndezja e shiut” (2001) etj. (Munish Hyseni)

KAJTAZI Severin (1936-). Kompozitor, producent. Lindi në Prizren, ku kreu shkollën e ulët dhe të mesme të muzikës. Në Prishtinë kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike. Kompozoi shumë këngë për pionierë dhe këngë argëtuese, pastaj operetën për fëmijë “Shtëpia e iriqit” dhe “Agimi i bukur” për solist, kor dhe orkestër. Ka kompozuar dhe muzikë për radio-drama. Janë të njohura këngët argëtuese: “Balada për Jan Palahun”, “Njeri ku je”, “Jevgia”, “Të kam pritë”, “Droja”, etj., ndërsa nga ato për pionierë: “Katarina”, “Zilja”, “Daci me skija” etj. Ka marrë pjesë në festivalet “Akordet e Kosovës”, Opatija etj. Në “Akordet e Kosovës” është shpërblyer katër herë me radhë, nga viti 1964 deri më 1967. Ka punuar në Produksionin muzikor të Radiotelevizionit të Prishtinës dhe ka qenë drejtor e producent. Jeton në Beograd. (Xhevdet Gashi)

KAJTAZI Sinan (1987-). Balerin. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme të Baletit dhe të Muzikës në Prishtinë. Në vitin e dytë të shkollës së baletit filloi edhe angazhimi i tij në shfaqjet e Baletit të Kosovës, ndërsa më vonë u bë pjesë e kësaj trupe. Nga viti 2008 është solist dhe bartës i shumë roleve kryesore nga shfaqjet klasike dhe moderne të repertorit të Baletit të Kosovës. Ka luajtur në shfaqjet: “Bukuroshja e fjetur”, “Carmen”, “Rapsodi mbi temat e Paganinit”, “Balloja e diplomës”, “Lidhja”, “Don Kishoti”, “Kopelia”, “Othello” etj. Gjithashtu ka qenë pjesë e të gjitha shfaqjeve të tjera të Baletit Kombëtar të Kosovës. Në vitin 2008 në kuadër të bashkëpunimit me “La Mama Theater” nga Nju-Jorku mori pjesë në shfaqjen e baletit të



SINAN KAJTAZI

këtij teatri “La Raven”. Ka realizuar edhe disa albume muzikore. (Ragip Sylaj)

KAJTAZI Vehbi (1981-). Gazetar. Lindi në fshatin Suhogërlle të komunës së Istogut. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Me gazetari filloi të merret nga viti 2006 në gazetën “Bota sot”, më pas në “Iliria Post”, “Kosova sot” dhe në vitin 2015 në gazetën “Koha ditore”, ku ndoqi zhvillimet në sektorin e drejtësisë. Së fundi shkrimet i publikoi në portalin “Insajderi”. Është shquar me shkrime të gazetarisë hulumtuese dhe është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve. (Nehat Islami)

KAJTAZI Xhavit (1955-). Gazetari i sportit. Lindi në Vitak. Kreu Fakultetin e Filologjisë, degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Universitetin e Prishtinës. Gjatë studimeve punoi



XHAVIT KAJTAZI

në gazetën studentore “Bota e re”, më pas në Televizionin e Prishtinës (1981-1985). Ishte gazetar dhe redaktor i sportit në gazetën “Rilindja” (“Bujku”), ndërsa pas luftës ishte redaktor i sportit në gazetën “Zëri”, kryeredaktor i gazetës “Kosova sport”, redaktor i sportit në “Infopress”, kryeredaktor i revistës së ilustruar “Arena sportive”, kryeredaktor i gazetës së përditshme “Sport”, kryeredaktor i gazetës “Topi”, redaktor i sportit në revistën e ilustruar “IP Magazinë”, redaktor i sportit në portalin “Publiku.net” etj. Në periudhën 2003-2005 ishte kryetar i Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës. Ka botuar disa libra nga fusha e sportit: “Fjalori i futbollit”, “Hendbolli i Kosovës, figura dhe dëshmi, 1958 – 2005”, “Futbolli i Kosovës, nga robëria në liri, 1991-1999”, “Hendbolli kosovar 1953-2013” etj. Xh. Kajtazi ishte njëri nga themeluesit, pastaj lojtar dhe trajner i klubit të volejbollit “Universiteti” (1974-2000), trajner i përfaqësueses së të rinjve të Kosovës (1981-1989), kur arriti të merrte vendin e katërt në ish-Jugosllavi, pas luftës trajner i KV “Mabetex” (2001-2006) me pesë tituj të kampionit dhe pesë herë fitues i Kupës së Kosovës, fitues i Superkupës gjithëkombëtare më 2006, trajner i KV “Prishtina” (2006-2009) me dy tituj të kampionit dhe dy herë fitues i Kupës

së Kosovës. Në vitin 2008 fitoi çmimin “Trajneri më i suksesshëm i Kosovës” në sportin e volejbollit. (Gani Kosumi)

KALAJ Vuksan (1942-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Pikalë të Tuzit (Mali i Zi), shkollimin e kreu në Tuz dhe Tivar. Studimet i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit (1968), ku mbaroi edhe studimet pas-universitare (1975) dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1982). Në vitin 1968 zgjidhet asistent në degën e kimisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës dhe më pas në FSHMN të Universitetit të Prishtinës i arrin të gjithë titujt universitarë. Ka publikuar punime shkencore në disa revista, ka marrë pjesë në tubime shkencore dhe është autor tekstesh shkollore. (Salih Gashi)

KALAJA E CËRMJANIT. Vendbanim kodrinor i antikës së vonë. Ngrihet mbi një kodër në formë konike, në veri të fshatit Cërmjan të komunës së Gjakovës (603 m). Shtrihet në rreth 1.3 ha dhe zë një nga pozitat qendrore në Rrafshin e Dukagjinit. Muret rrethuese ndjekin izohipsën më të përthyer të kodrës, duke i dhënë kalasë formë jo të rregullt vezake. Ledhet janë ndërtuar nga gurë shkëmborë dhe copa tjegullash e tullash, të lidhur më llaç gëlqereje apo me argjilë (1.85-2 m). Në disa trakte muresh gjendet edhe teknika e thatë e murimit, e bërë vetëm me gurë. Në anën lindore dhe jugore kishte tri kulla, planimetria e të cilave nuk duket qartë. Sipas gjetjeve të qeramikës, kalaja është ndërtuar në antikën e vonë, kurse jeta në të ka vazhduar edhe në mesjetë. (Haxhi Mehmetaj)

KALAJA E DUBOCIT. Vendbanim shumë-shtresor parahistorik, i antikës së vonë dhe i mesjetës. Ngrihet mbi fshatin Duboc, në lindje të lagjes së Zyqakëve dhe afër maleve të Çiçavicës, rreth 12 km në perëndim të Vushtrrisë. Zë hapësirë prej 3-4 ha të kodrës konike (673 m). Njihet dhe me toponimin “Gjyteti”. Sipas gjetjeve të gërmimeve (sondazhi në vitet ‘70 të shek. XX), është konstatuar se është themeluar gjatë epokës së hekurit dhe se përmban materiale të periudhës paraurbane dardane (shek. VI-IV). Sipas strukturës së ndërtimit të mureve rrethuese, i takon fortifikatave dardane të rindërtuara nga perandori bizantin Justiniani I (shek. VI). Gjatë aktiviteteve

bujqësore është gjetur dhe një fragment stelle me mbishkrim latin dhe dy fragmente të shtyllave. (Pleurat Kabashi)

KALAJA E DURMANIT. Vendbanim i fortifikuar kodrinor i antikës së vonës (shek. III-VI). Ngrihet në lindje të Rahovecit, mbi kodër me pozitë të mirë gjeostrategjike. Ka formë të zgjatur jo të rregullt drejtkëndore, me mure në anët e gjata rreth 200 m dhe në ato të shkurtra 44-55 m. Kishte pesë kulla në anën jugore, tri në trajtë drejtkëndore dhe dy në trajtë patkoi. Muret janë ndërtuar me teknikën opus incertum, me gurë të lidhur me llaç gëlqeror (1,40 x 0.20-1,10 m). Shquhet për cilësi të mirë ndërtimi krahasuar me kështjellat e tjera të pellgut të mesëm të Drinit të Bardhë. (Haxhi Mehmetaj)

KALAJA E HARILAQIT. Vendbanim i fortifikuar shumështrësor. Ndodhet në fshatin Harilaq (Fushë-Kosovë), mbi një kodër me lartësi prej 768 m dhe kishte pozicion të



KALAJA E HARILAQIT

rëndësishëm gjeostrategjik, nga ku sigurohej kontrolli i një hapësire të gjerë gjeografike. Shtrihet në sipërfaqe prej 1.3 ha dhe ka mure rrethuese të punuara me teknikën “opus incertum” dhe “opus mixtum”, të gjëra 1.30-2.20 m. Përgjatë tij gjenden katër porta, dy kulla katrore dhe një trekëndëshe. Në të u konstatuan edhe struktura të tjera arkitekturore, profane dhe sakrale, si dhe një repertori i pasur i materialit arkeologjik. Kompleksi sakral paleokristian është zbulimi më i rëndësishëm dhe ky përbëhet nga një kishë dhe dy objekte identike për nga forma, planimetria, dimensionet dhe struktura e ndërtimit. Këto duket se paraqesin mbetjet e dy martirëve, Shën Florit dhe Shën

Laurit. Si i tillë, kompleksi paraqet tërësinë më të veçantë të këtij lloji të zbuluar në tërë Ballkanin Qendror. Gjurmët e para të banimit i takojnë epokës së eneolitit, por jeta vazhdoi dhe gjatë epokës së bronzit e të hekurit e deri në mesjetën e hershme. Intensitetin me të madh e njohu në shek. IV-VI, braktiset në shek. VII. Ishte qendër e rëndësishme pelegrinazhi gjatë antikitetit të vonë dhe mund të ubifikohet me fortifikatën Aria të zënë në gojë nga Prokopi (“Mbi Ndërtimet”). U identifikua nga E. Shukriu (1986), ndërsa kërkimet arkeologjike u zhvilluan nga Muzeu i Kosovës (2005-2013). (Arben Hajdari)

KALAJA E KEQEKOLLËS. Vendbanim kodrinor i antikës së vonë. Ngrihet mbi kodër mbizotëruese malore, te fshati Keqekollë (864 m). Njihet edhe me emrin “Gjytet”. Kishte pozitë strategjike mbi një segment të rëndësishëm të trasesë së rrugës vicinale, e cila ndërlidhej me rrugët antike Nish-Lezhë dhe Keqekollë-Leskoc. Ishte e fortifikuar me mure prej gurësh mesatarë dhe të vegjël (1.80-2.00 m), të lidhur me llaç të bardhë gëlqereje. Fortifikata ka trajtë drejtkëndëshi të çrregullt (40 a), muret e së cilës kanë ndjekur linjën më të lartë të izohipsës së kodrës. Mbrohej në anën jugore me një kullë drejtkëndore, më shtesë ballore në formë trekëndëshi. Kishte dy hyrje, njëren për karroca në mesin e murit perëndimor e tjetrën për këmbësorë në këndin verilindor. Sipas gjetjeve arkeologjike, sidomos të enëve të qeramikës së zbukuruar më krehër dhe teknikave të murimit, kalaja i takon shekujve IV-VI dhe mund të identifikohet si Kekola, kështjellë e antikitetit të vonë e shënuar nga Prokopi. (Haxhi Mehmetaj)

KALAJA E NOVOBËRDËS. Kala mesjetare në Kosovën Lindore. Ndodhet ndërmjet Përlepnicsës dhe Krivarekës, rreth 30-35 km në perëndim të Gjilanit dhe rreth 39 km në juglindje të Prishtinës. Përmendet në dekadat e para të shekullit XIV, me emrin Novus Mons/Novamonte dhe në tekstet saksone si Nyeuberghe. Në të dhënat historike shfaqet si një qendër e minierave dhe qendër tregtare, në të cilën tregtarët raguzanë bënin tregti dhe kishin në të zyrën doganore dhe një konsull. Argjendi dhe ari i Novobërdës është kërkuar shumë, si nga tregtarët raguzanë, ashtu edhe më vonë nga osmanët. Në të janë farkuar



KALAJA E NOVOBËRDËS

edhe monedha dhe janë gjetur shumë i mallra luksoze mesjetare, që dëshmon prosperitetin dhe statusin e lartë të qytetit. Qyteti mesjetar ishte vendbanim xehetar dhe në të janë ruajtur kështjella me kulla mbrojtëse, themele të monumenteve sakrale dhe të godinave në kuadër të kalasë dhe jashtë saj. Kalaja përbëhet nga Qyteti i Epërm dhe Qyteti i Poshtëm. Qyteti i Epërm është ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës, ndërkaq nën të, në drejtim të perëndimit, shtrihet qyteti i poshtëm me bazë në formë eliptike. Qyteti ka qasje vetëm nga pjesa lindore. Nga pjesët e tjera pjerrësia e kodrës është shumë e theksuar në drejtim të luginës dhe ka krijuar mbrojtje natyrore. Në pjesën lindore terreni ngrihet gradualisht dhe kalon në kodër tjetër më të vogël, në platonë e epërme, nën të cilën gjenden rrënojat e një kishe të madhe mesjetare të tipit katedrale. Qyteti i Poshtëm (Nënkalaja) shtrihet në kodrat lindore dhe juglindore, deri te miniera nën Malin e Madh. Kalaja është pushtuar nga osmanët në vitin 1445 dhe është përdorur deri në vitin 1687. Gërmimet e para arkeologjike janë zhvilluar në vitet 1957-1958 nga Muzeu Ushtarak i Jugosllavisë, në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik të Republikës së Serbisë dhe vazhdojnë dhe sot nga institucionet e Republikës së Kosovës. Shërben si atraksion trashëgimor turistik dhe në proces është konservimi i Kalasë. Jo larg gjendet një vendbanim i fortifikuar parahistorik “Lëma e Artë” dhe kjo, bashkë me galeritë edhe të periudhës romake, dëshmon shfrytëzimin e hershëm të minierave të pasura të Novobërdës. (Arben Arifi)

KALAJA E PIDIQIT. Vendbanim kodrinor parahistorik dhe antik. Ndodhet në zonën e

Karadakut, mes fshatrave Shurrddhan dhe Pidiq. U ngrit mbi një kreshtë shkëmbore, në pjesën më të lartë të së cilës ruhen gjurmët e një kulle, të ndërtuar nga gurë të lidhur me llaç gëlqeror (2 x 1.5 m). Vërehen edhe trakte të mureve të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqeror. Bazuar në konfiguracionin e terrenit dhe sipas gjurmëve të ruajtura, vendbanimi kishte mur rrethues dhe me ndërtime të tjera në brendi, të cilat, për nga teknika e ndërtimit dhe materialit të lëvizshëm, i takojnë periudhës së antikitetit të vonë. Hulumtimi arkeologjik u zhvillua nga Muzeu i Kosovës (1983). Sipas materialit arkeologjik dhe arkitektonik, vendbanimi u banua nga epoka e bronzit të vonë, gjatë epokës së hekurit e deri në antikën e vonë. (Kemajl Luci)

KALAJA E POGRAJËS. Vendbanim i fortifikuar i antikës së vonë. Gjendet mbi rrjedhën e Moravës së Binçës, në grykën e Llapushnicës te fshati Pograjë (567 m), rreth 10 km në juglindje të Gjilanit. Planimetria e kështjellës ka formë të pesëkëndëshit të çrregullt dhe muri jugor i kullës qendrore ka rolin e murit mbrojtës të kështjellës. Në pjesën më të lartë ruhen gjurmët e një kulle vështruese, muret e së cilës shkojnë deri në 10 m lartësi (8 x 8 m). Në akset e kalasë gjenden kullat më të vogla në pjesën perëndimore, veriore dhe verilindore, të cilat vende-vende ruhen në lartësinë prej afër 4 m. Kalaja ka sipërfaqe të brendshme prej rreth 1.2 ha dhe është ndërtim tipik për shek. VI. (Arben Arifi)

KALAJA E PRESHEVËS. Vendbanim i fortifikuar i antikës së vonë dhe i mesjetës. Gjendet mbi një kodër të lartë, rreth 1.6 km në perëndim të Preshevës (749 m). Ka trajtë përafërsisht elipsoide, me mure të ndërtuara me teknikë opus insertum. Muret e dukshme rrethuese i përvijojnë izohipsat. Nga mbetjet mund të shihet vetëm një pjesë e kullës. Platoja e kalasë është rrafshuar dhe ka rënie në drejtim të lumit. Në sipërfaqe të platosë janë të dukshme themelet e një objekti antik, themele prej gurësh, si dhe tjegullat dhe qeramika e antikës së vonë. Rreth kalasë gjenden lokalitetet e tjera, të cilat mbajnë toponimet Gradishta dhe Kisha. (Arben Arifi)

KALAJA E PRIZRENIT. Vendbanim i periudhës antike, mesjetare dhe osmane. Është ndërtuar mbi një masiv shkëmbor, me pozitë



PAMJE E KALASË SË PRIZRENIT

të veçantë gjeostrategjike, e cila mundëson të mbikëqyrjen e rrugëve që lidhin Adriatikun dhe Ballkanin Qendror, apo rrugën që shkonte përmes luginës së Lumbardhit në drejtim të pellgut të Shkupit e të Tetovës. Gërmimet arkeologjike nisën në vitin 1969 (Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe të Natyrës, Prizren) dhe vazhduan në vitet 2004, 2009-2011, 2013-2015 nga Instituti Arkeologjik i Kosovës. Kalaja ka murin rrethues të përforcuar me kontrafore dhe kulla të vendosura brenda dhe jashtë murit. Ka pesë porta, prej të cilave ajo perëndimorja paraqet portën kryesore, si dhe daljen sekrete, tunelin. Porta dhe kulla gjenden edhe në muret ndarëse brenda kalasë. Brendia e kalasë ka tri komplekse: Qytetin e Epërm, Qytetin e Poshtëm dhe Qytetin Jugor. Pas gërmimeve të vitit 2015, u dëshmuar dhe një ndarje në Qytetin e Poshtëm, i emëruar si Qyteti Verior. Janë zbuluar një numër kazamatësh gjysmëharkore, kulla e sahatit, depoja e barutit, magazina, mulliri, xhamia, hamami, pjesë të rrugëve etj. Ka indikacione se kalaja ka qenë e banuar që nga periudha e bronzit të vonë. Periudha e antikës, pos materialit arkeologjik, është dëshmuar edhe me zbulimin e disa trakteve të mureve, ndërsa jeta ka vazhduar edhe gjatë mesjetës dhe periudhës osmane. Kalaja ka shërbyer si vend i rëndësishëm banimi dhe strehimi për banorët që jetonin në rrethinë dhe ka pësuar në vazhdimësi ndryshime, ndërsa viti 1912 shënon fundin e përdorimit të saj si fortifikatë. Megjithatë, ajo edhe për një kohë vazhdoi të përdorej si depo armësh dhe si burg. Pas vitit 1914 iu nënshtrua një shkatërrimi të madh, nga faktori njeri dhe ai natyror. Pozita dominante mbi qytetin e Prizrenit, peizazhi natyror mjaft tërheqës dhe strukturat arkitek-

tonike që i përshtaten shumë mirë konfiguracionit të terrenit e bëjnë objekt me vlera të rëndësishme arkeologjike, historike dhe të turizmit kulturor. (Shafi Gashi)

KALAJA E STROCIT. Vendbanim kodrinor i fortifikuar. Gjendet në fshatin Stroc të Drenicës dhe njihet edhe me toponimin Gradina. Toponimi i dytë është tregues se ky lokalitet arkeologjik është banuar që në parahistori, për të vazhduar jeta në të dhe gjatë antikës e mesjetës së hershme. Në shpatet e kodrës gjenden mure të vendosura në formë të kaskadave, të cilat shkojnë deri majë kodrës. Kalaja ka themele të mureve rrethuese dhe të kullave në trashësi deri në 2 m. Sipas gjurmëve të evidentuara, supozohet se në të gjendej dhe një objekt me karakter kulturi. (Arben Arifi)

KALAJA E SYRIGANËS. Vendbanim kodrinor i antikës së vonë (shek. IV-VI). Njihet dhe me toponomin “Gradina”, që sugjeron të ketë qenë dhe vendbanim parahistorik. Gjendet në veri të Syriganës (Suhogerllë), rreth 20 km në veriperëndim të Skënderajt. U ngrit mbi shkëmb natyror, me shtrirje lindje-perëndim dhe mbrojtje natyrore nga jugu, perëndimi dhe veriu. Ka dominim vizual mbi një pjesë të madhe të Drenicës dhe të Llapushës dhe korrespondon edhe me “Sukën e Cërmjanit” (Gjakovë) dhe Gradinën e Kotorrit (Mitrovicë) në juglindje. Në të janë evidentuar gjurmë të horasanit, fragmente tjegullash dhe të qeramikës, ndërsa gurët e përpunuar të mureve janë përdorur nga banorët vendës. Në afërsi gjenden rrënojat e kishës së krishterimit të hershëm dhe është banuar edhe gjatë mesjetës. (Arianit Buqinca)

KALAJA E TENEZHDOLLIT. Vendbanim i fortifikuar kodrinor shumështrësor, i cili përmban material arkeologjik nga parahistoria deri në mesjetë. Nndodhet në juglindje të Tenezhdollit, në të majtë të luginës së lumit Llap, pranë magjistrales antike Naissus-Lissus. Ngrehet mbi kodrën në formë trekëndëshi dhe njihet me emrin “Kulina e Vogël” (rreth 1.2 ha). Ka pozitë të mirë gjeostrategjike mbi luginë dhe kurorat e kodrave e të maleve. Gjurmimet e H. Mehmetajt (1988) dëshmuar shtresime nga periudha e bronzit deri në mesjetë. Vazhdimësia e jetës ndiqet veçanërisht gjatë dy fazave të epokës së hekurit, fazës së

parë (shek. VIII-VII) dhe fazës së dytë (shek. VI-fillimi u shek. IV p.e.r.). Në fazën e parë shquhet qeramika dardane e punuar me dorë, e zbukuruar me instrument të dhëmbëzuar, kanelyra, mollëza gishti dhe pikëzime. Në fazën e dytë shfaqen enët luksoze vendëse të punuara me qarkun e poçarit dhe importe të qeramikës. Qeramikës së importuar të shek. IV p.e.r. i takon dhe buza e enës me mbishkrim të skalitur në alfabetin grek: ΑΙΤΟΥΓΑΝ. (Haxhi Mehmetaj)

KALAJA E VUSHTRRIË. Kala e shek. XIV, e cila ngrihet mbi terren të sheshtë fushor, në qendër të qytetit të vjetër të Vushtrrisë. Është ndërtuar nga gurët ranorë dhe gurët lumorë, të lidhur më llaç gëlqeror. Përbëhet prej dy pjesëve, mureve rrethuese në perëndim dhe kullës dykatëshe në lindje. Kalaja ka planimetri drejtkëndore (32 x 32 x 6 m) dhe muret janë të gjera 2 m. Kulla është drejtkëndore (11.30 x 11.30 x 8 m). Muret fortifikuese mbështeten në skajet e mureve anësore të kullës, duke lënë pjesën më të madhe jashtë mureve rrethuese. Kalaja kishte dy hyrje, njërën për karroca (mesi i murit rrethues jugor) dhe tjetrën për këmbësorë (skaji lindor i murit rrethues). Hyrja e veçantë në kullë ndodhej në mesin e murin perëndimor. (Haxhi Mehmetaj)

KALAJA E ZATRIQIT. Vendbanim kodrinor i lartë, i banuar nga epoka e eneolitit deri në mesjetë. Gjendet në verilindje të fshatit Zatriq të Rahovecit (1040 m) dhe njihet edhe me emrin “Gradishta e Madhe”. Fortifikimi i antikitetit të vonë ngrihet në majën e tarracës shkëmbore të kodrës në formë trekëndëshi, me pozitë jashtëzakonisht të mirë strategjike. Muret rrethuese janë ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur më llaç të gëlqeres dhe këto përgjithësisht ndjekin izohipsat e terrenit. Në anën jugore muret ndërliidhen më terrenin shkëmbor, i cili i siguron kalasë mbrojtje natyrore. Fortifikimi përfshin sipërfaqe prej 20 ari. Hyrja në të gjendet në anën veriperëndimore. Gjurmë banesash gjenden në tarracën e dytë, jashtë mureve rrethuese. Pranë vendbanimit gjendet dhe kodra e quajtur “Gradishta e Vogël”, por në të nuk janë ruajtur gjurmë banimi. (Haxhi Mehmetaj)

KALATË. Vendbanime të fortifikuara, tani monumente kulturore-historike më rëndësi dhe

rol të veçantë për artin e fortifikimeve. Në territorin e Kosovës ekziston një numër i konsiderueshëm i kalave. Ato janë të tipit fushor dhe kodrinor, por në të gjitha rastet ato janë rrënoja, të ngritura mbi ndërtimet fillestare të kohës së bronzit, të hekurit ose më vonë. Shumica e këtyre kalave u rindërtuan dhe u ndërtuan gjatë mesjetës së hershme, gjatë sundimit të Justinianit në veçanti (shek. VI) dhe periudhës osmane, si: kalaja e Prizrenit, Novobërdës, Pogradit, Zveçanit, Sforcit etj. Ndërtimet e mëvonshme kodrinore ruajnë mjaft elemente origjinale të kohës së ndërtimit. Kalatë që ishin në përdorim gjatë historisë mbi tremijëvjeçare, dëshmojnë për ekzistimin e vendbanimeve të fortifikuara të banorëve autoktonë. Fortifikimet e mëvonshme nuk kanë sjellë asgjë të re, pos riparimeve dhe adaptimeve për nevojat e kohës dhe të armëve që përdorshin, qofshin këto rindërtime të periudhës romake, bizantine apo osmane. Rindërtimet e kalave u bënë kryesisht në kuadër të ambienteve autoktone. Rrënojat e kalave ekzistuese, pos tjerash, ruajnë konfiguracionin e terrenit dhe planimetrinë. Kalatë kanë porta si dhe kulla në kuadër të mureve konstruktive. Kullat, si objekte mbrojtëse, kanë bazë dhe planimetri të ndryshme: janë kënddrejta, gjysmërrethore, në formë patkoi etj. Kullat kanë frëngji, varësisht prej armëve që përdoren. Si material ndërtimor përdorej guri natyral, ndonjëherë vetëm pak i përpunuar, herë të tjera i përpunuar dhe i lidhur më llaç gëlqereje, në periudhën romake në veçanti. Guri i përpunuar është aplikuar në dyert e kalave. Kalatë kanë pjesën qendrore ose citadelën, e cila ka kulla për banim dhe mbrojtje. Pos elementeve mbrojtëse, kalatë kanë edhe mbrojtje natyrore. Kalatë kodrinore në territorin e Kosovës kanë pozitë zotëruese mbi hapësirat që shtrihen para tyre. (Fejz Drançolli)

KALAVESHI Musa (1954-). Pikturor. Lindi në Mitrovicë. Mbaroi arsimin bazë në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Kreu Akademinë e Arteve, drejtimi i pikturës, në Prishtinë, në vitin 1979. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovë nga viti 1980. Individualisht ekspozoi në Shtëpinë e Kulturës në Mitrovicë më 1979 dhe 1982, kurse aktivisht mori pjesë në të gjitha ekspozitat e organizuara nga SHAFK-u, si Salloni Pranveror e Vjeshtor, bienalet dhe trienalet e vizatimit etj. Mori pjesë në ekspozitat e përbashkëta “Për demokraci”

(Prishtinë 1990), “Homazh për Nënë Terezën”, Salloni i Karikaturës (në Galerinë e Arteve, Prishtinë), në ekspozitën e qytetit në Orkun dhe Antali (Turqi), si dhe në aktivitetet të tjera brenda dhe jashtë vendit. Me një stil tërheqës kultivon portretin dhe peizazhin. (Rexhep Ferri)

KALECI Arsim (1966-). Aktor. Lindi në Velestë të Strugës. Në Shkup kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike për matematikë dhe fizikë, ndërsa në Universitetin e Tetovës mbaroi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve. Luajti në një sërë rolesh në projekte të ndryshme teatrore, si: “Dhëndër nga Parisi” (1998), “Kipci Muzeu” (2000), “Burri-burrë” (2000), “Duke pritur Sarën” (2007), “Dashuri, teatër dhe marrëzi të tjera” (2012) etj. Aktroi në filmin “Shi në gjak” dhe në serialin “Përralla shqiptare” me regji të S. Nuredinit. Në vitin 1991 ishte njëri ndër themeluesit e teatrit “Sofra”. Është anëtar i trupës së Teatrit të Tetovës që nga themelimi i tij. (Salajdin Salihu)

KALESHI Hasan (1922-1976). Orientalist, historian, etnograf, albanolog. Lindi në Serbicë të Kërçovës. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas në Medresenë “Mbreti Aleksandër”




HASAN KALESHI

në Shkup dhe në shkollën e mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë. U diplomua në degën e orientalistikës në Beograd (1951). Më 1960, po në Beograd, mbrojti disertacionin e doktoratës me titull “Dokumentet më të vjetra të vakëfëve të Maqedonisë në gjuhën arabe”. Më 1967 u zgjodh bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, tri vjet më vonë profesor në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ishte anëtar i redaksisë së disa revistave vendore dhe ndërkombëtare: “Gjurmime albanologjike”, “Vjetar i Arkivit të Kosovës”, “Balkanica” (Beograd), “Prilog za orijentalnu filologiju” (Sarajevë), “Der Islam” (Berlin), “Uralo-Altischen Jahrbuch” (Hamburg), “Sudost Forschungen” (Munih). Kontributi i tij shtrihet në shumë fusha: historiografi shqiptare dhe studime orientale. La shumë njësi bibliografike, ku përfshihen punime shkencore, artikuj, përkthime, kritika, re-

censione etj. Punimet e tij shkencore u botuan në revista brenda dhe jashtë vendit. Mori pjesë me referate në konferenca e simpoziume të ndryshme shkencore në Gjermani, Turqi, Bullgari, Itali, Greqi e gjetiu. Kritikoi teza të historiografisë shqiptare lidhur me islamizimin, për çka ndërlihet me teza të historiografisë serbe dhe turke. (Jahja Hundozi)

KALESHI Omer (1932-). Piktur. Lindi në Serbicë të Kërçovës. Kreu shkollën e mesme teknike në Shkup. Në vitin 1956 emigroi në Turqi dhe pas dy vjetësh fillon studimet në



OMER KALESHI

Akademine e Arteve të Bukura në Stamboll, të cilat i përfundoi më 1965. Në veprat e tij Kaleshi bën sintezën që përqendrohet në ndikimet orientale-okcidentale. Interes i tij është gjithnjë portreti, figura e njeriut. Në vitin 1963 në Stamboll u hap ekspozita e tij e parë personale. Më pas ekspozoi në shumë galeri të njohura të artit. Në vitin 2002 në “Salle des pas perdus” të UNESCO-s u hap ekspozita e krijimtarisë së tij me tematikë Shqipërinë, Maqedoninë dhe Turqinë, për t'i sjellë publikut mesazhe humaniste nga Ballkani. Emri i tij hyri në botimin katërgjuhësh “Fjalor europian i artistëve bashkëkohorë” (Dizionario degli Artisti Europei Contemporanei) botuar në Itali më 1980. Në vitin 2009 u shpall qytetar nderi i Kërçovës. Në kolegjin “Iliria” në Prishtinë u hap një galeri e përhershme me emrin Omer Kaleshi. Në vitin 2014 u shpall qytetar nderi i komunës së Çairit në Shkup për kontributin e dhënë në fushën e arteve figurative si dhe për përhapjen dhe promovimin e kulturës shqiptare në Europë dhe më gjerë. Është fitues i disa çmimeve dhe mirënjohjeve publike. Jeton dhe vepron në Paris. (Jëlldeze Asani)

KALLABA Isa (1943-). Kimist, teknolog. Lindi në Roganë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjilan, ndërsa Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, dega e kimisë, e kreu në Prishtinë (1968). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Zagrebit. Pas studimeve u punësua në kombinatin “Kosova”, në repartin e Azotikut në Obiliq. Më vonë punoi si profesor i lëndës së kimisë në disa shkolla të

mesme në komunën e Kamenicës. Ishte drejtor i Fabrikës së Qeramikës në Kamenicë nga viti 1879. Kreu disa specializime për qeramikë në fabrika të ndryshme, si në Zagreb, Bolonjë, Firencë etj. Mori pjesë në disa simpoziume të rëndësishme shkencore, të cilat kishin të bënin me proceset e përpunimit dhe të finalizimit të lëndës së parë të porcelanit. Në vitin 1982 kaloi me punë në Entin Higjienik të Prishtinës. Nga viti 1982 deri më 1986 specializoi në lëmin e bromatologjisë në Zagreb. (Fejzullah Krasniqi)

KALLUDRA Xhevdet (1939-). Inxhinier i teknologjisë. Lindi në Mitrovicë. Shkollën filllore dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, studimet në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Sarajevës (1965). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit të Zagrebit. Pas diplomimit punësohet në kombinatin xehetar-metalurgjik “Trepça”, në industrinë kimike, si inxhinier praktikant e më vonë si konsulent për prodhimin e plehrave artificiale në bazë të mesprodukteve nga metalurgjikët. Në Trepçë kreu një varg detyrash udhëheqëse dhe profesionale, në metalurgjinë e zinkut, në metalurgjinë e plumbit dhe në Institutin e plumb-zinkut. Nga viti 1967 ishte i angazhuar në procesin mësimor si asistent dhe ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike dhe në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë. Në vitin 1990 u largua nga puna pas zbatimit të masave të dhunshme nga Serbia. (Shyqeri Kelmendi)

KALLËZIMET. Krijim i prozës popullore, që trajton një ngjarje, ndodhi ose dukuri të jetës, e cila është veçuar dhe është ngritur mbi të tjerat. Tematika e kallëzimit është e lidhur me marrëdhëniet ndërmjet burrit dhe gruas, të anëtarëve të familjes, njerëzve të shtresave të ndryshme shoqërore etj. Dinakëria, mençuria, virtytet e veset e ndryshme etj., trajtohen në krijimet e këtij zhanri. Kallëzimi nuk ka strukturë të ndërlikuar, rrëfimi është i drejtpërdrejtë, i qartë. Esenca e rrëfimit realizohet nëpërmjet gjuhës së rëndomtë, duke nuancuar detaje, momente psikologjike dhe përbërës të tjerë, që dallohen nga veprimet në jetën e përditshme. Tematika e kallëzimeve përqendrohet në stigmatizimin e dukurive shoqërore negative dhe në veset e individit si pjesëtar i familjes dhe i shoqërisë. Një grup më vete përbëjnë kallëzimet humoristike, që rrëfehen

për të krijuar atmosferë të gëzueshme dhe argëtuese. Poenta e tyre qëndron në elementin humoristik, mashtrimin, dredhinë, zbatimjen etj. Kallëzimet popullore janë përfshirë në kuadër të botimeve të shumta të krijimtarisë gjore. (Myzafere Mustafa)

KAMATA. Një tarifë interesi që i paguhet pronarit të asetëve nga një huamarrës, si formë e kompensimit për shfrytëzimin e asetëve. Më së shpeshti kamata përfaqëson çmimin e paguar për përdorimin e parave të huazuara ose për paratë e fituara nga fondet e depozituara. Kur paratë janë të huazuara, interesi i paguhet huadhënësit si një përqindje e kryegjësë apo shumë që huamarrësi i detyrohet huadhënësit. Përqindja e kryegjësë që paguhet si një tarifë për një periudhë të caktuar kohe (zakonisht një muaj apo një vit) quhet norma e kamatës. Një depozitë bankare do të fitojë interes, sepse banka paguan për përdorimin e fondeve të depozituara. Interesi është kompensim për huadhënësin, për të mbuluar rrezikun e humbjes së kryegjësë, që quhet rrezik kreditor, apo për heqjen dorë nga investime të tjera që mund të jenë bërë me paratë e dhëna hua. Në ekonomi kamata konsiderohet si çmimi i kredisë. Sektori bankar i Kosovës, që nga fillimi i operimit, është karakterizuar me norma relativisht të larta të interesit, posaçërisht në kredi. Niveli i lartë i normave të interesit deri-diku mund t'i atribuohet faktit se sistemi bankar i Kosovës është një sektor mjaft i ri dhe, si i tillë, u ballafaqua me shpenzime të larta operacionale, ku, ndër të tjera, mund të përfshihen shpenzimet e zgjerimit të rrjetit të degëve dhe të nëndegëve, pastaj trajnimi i stafit etj. Po ashtu, bankat u ballafaquan me historikun e shkurtër kreditor të klientëve, me një sistem ligjor joefikas, si dhe me një ambient afarist në konsolidim e sipër, gjë që ndikoi në një shkallë më të lartë të rrezikut të vlerësuar nga bankat. Sidoqoftë, zhvillimi i vazhdueshëm dhe rritja e konkurrencës së sektorit bankar, krahas avancimit të infrastrukturës financiare dhe përmirësimit të ambientit afarist në vend, ndikoi që norma e interesit të shënojë rënie të vazhdueshme. Rënie me e theksuar u regjistrua gjatë vitit 2014, kur norma e interesit në kredi u zvogëlua në 9.2%, nga 11.1% sa ishte në dhjetor 2013. Këtij zvogëlimi i parapriu edhe rënie e normës mesatare të interesit në depozita, që zbriti në 1.1% në dhjetor 2014, nga 2.4%, sa

ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. (Valentin Toçi)

KAMBERAJ Sinan (1949-). Gazetar. Lindi në Suhogërril (Syrganë) të Istogut. Shkollën fillore e kreu në Rakosh, ndërsa gjimnazin në Mitrovicë dhe shkollën normale në Prizren. Disa vjet punoi mësues në Uçë të Istogut. Më 1974 mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë studimeve ishte edhe gazetar në gazetën e studentëve “Bota e re”. Më 1974 filloi punën e gazetarit në programin për kulturë në Televizionin e Prishtinës (TVP). Pas demonstratave të vitit 1981 iu ndalua puna e gazetarit dhe punoi përkthyes deri në vitin 1990, kur Serbia e mbylli RTP-në. Në vitin 1991 bëhet korrespondent nga Prishtina i gazetës shqiptaro-amerikane “Illyria” në Nju-Jork. Një vit më vonë shkoi në Nju-Jork, ku kreu punën e redaktorit të kësaj gazete deri në vitin 1998. Përveç shkrimeve publicistike, botoi poezi, prozë dhe skica humoristike-satirike. Botoi librin me poezi humoristike-satirike “Këngë çeroike kosovare” (2010). Jeton në Nju-Jork. (Ibrahim Berisha)

KAMBERI Bedri (1937-). Kimist, profesor universiteti. Lindi në Nakolec të Prespës (Maqedoni). Shkollimin bazë e kreu në vendlindje dhe në Shkup, studimet për kimi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1964). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Beogradit, ku mbrojti edhe tezën e disertacionit (1976). Një kohë punoi mësimsdhënës në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë dhe më pas u zgjodh asistent në degën e kimisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku në vitet vijuese i arrin të gjithë titujt universitarë. Ka qenë kryeredaktor i buletinit të kimistëve dhe teknologëve të Kosovës, ka publikuar punime në revista të ndryshme dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore. Është autor i teksteve për shkolla të mesme dhe i një teksti universitar (“Bazat teorike të kimisë së përgjithshme dhe inorganike”). (Salih Gashi)

KAMBERI Belgzim (1975-). Gazetar. Lindi në Namur, Belgjikë. Shkollimin e kreu në Namur të Belgjikës dhe në Preshevë, ndërsa studimet për gjuhë frënge i mbaroi në Prishtinë. Studimet

pasuniversitare për shkenca politike i përfundoi në Universitetin e Parisit VIII në Francë. Është gazetar dhe redaktor përgjegjës në portalin frankofon “Le Courier des Balkans” (balkans.courriers.info). Punoi për disa medie të huaja dhe rajonale, siç janë Agjencia France Presse (AFP), Radio France Internationale (RFI), IWPR/BIRN, Televizioni Top Channel, si dhe bashkëpunoi me informacione nga rajoni me mediet dhe gazetatat e njohura “Le Monde”, “El Mundo”, “New York Times”, “Economist”, BBC, “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, “The Guardian”, “Arte”, “Le Figaro” etj. B. Kamberi kreu trajnime edhe në fakultetet e gazetarisë në Strasburg (CUEJ) dhe Lille (ESJ). Ligjëroi edhe në disa shkolla dhe kurse rajonale të gazetarisë. (Zija Rexhepi)

KAMBERI Esat (1943-). Gazetar. Lindi në fshatin Skyfteraj të Vitisë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, përkatësisht në Viti, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Punën e gazetarit e nisi në revistën “Zëri i rinisë”, ku për një kohë ushtroi detyrën e zëvendëskryeredaktorit, ndërsa më vonë u emërua ndihmës sekretar i Sekretariatit Krahinor të Arsimit, Kulturës dhe Shkencës së Kosovës. Ushtrroi edhe funksione të tjera në institucionet arsimore dhe kulturore të Kosovës. Ndërkohë, si bashkëpunëtor i jashtëm, botoi një sërë tekstesh nga lëmi i kulturës dhe i artit në “Rilindje”, “Flaka e vëllazërimit”, “Fjala”, “Jeta e re” etj. Është autor i librave publicistikë “Kultura dhe këmbimi i lirë i punës” (1984), “Etnokulturocidi në Kosovë” (1999) dhe i romaneve “Rrëfimet e idhullit” (2006) dhe “Hijet e natës” (2011). (Shaqir Foniqi)

KAMBERI Nerimane (1967-). Shkrimtare, mësimsdhënëse e letërsisë frënge në Universitetin e Prishtinës. Lindi në Preshevë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Belgjikë, drejtimi i gjuhëve të huaja dhe latinishtes. Po aty, për dy vjet, studioi në Fakultetin Juridik, pastaj u kthye në Kosovë, ku vazhdoi studimet për jurisprudencë dhe gjuhë e letërsi frënge. Më 1992 u diplomua në Fakultetin e Filologjisë,



NERIMANE
KAMBERI

ku më pas kreu edhe studimet pasuniversitare. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës mbi kritikën franceze për veprën e Ismail Kadaresë (2012). Punoi si asistente dhe përkthyes e disa medieve franceze, anglosaksone dhe spanjolle. Tani shkruan artikuj gazetareskë në revistën on-line “Le Courier des Balkans”. Në moshë të re botoi dy libra në gjuhën frënge dhe shqipe, për fëmijë dhe të rinj, që u botuan në Belgjikë: “Anjesa dhe doktor Simoni” (1983) dhe “Anjesa dhe shtatë pikturat” (1986). Ndërsa për të rritur shkroi dhe botoi përmbledhjen me poezi “Bluxhinet e grisur” (1991). Është autore e një libri me tregime të shkurtra: “Një ditë ndoshta” (2006). (Agron Gashi)

KAMBERI Shaip (1964 -). Gazetar. Lindi në Tërrnoc të Bujanocit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për drejtësi në Universitetin e Prishtinës. Në periudhën 1989-1995 punoi ndihmësavokat në Bujanoc, më pas u angazhua në jetën politike të komunës së Bujanocit. Më 1999 u angazhua bashkëpunëtor profesional i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMDLNJ) për Luginën e Preshevës, ndërsa në vitin 2000 themeloi organizatën e pavarur “Këshilli për të drejtat njeriut”, e cila merret me monitorimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Më 2001 filloi bashkëpunimin me të përditshmen “Zëri”, për të cilën raportoi për zhvillimet në Luginën e Preshevës. Më 2008 u zgjodh kryetar i komunës së Bujanocit, detyrë që e ushtroi deri më 2012. Më 2014 u zgjosh deputet i Partisë për Veprim Demokratik (PVD) në Parlamentin e Serbisë. Në të përditshme “Zëri” vazhdon të publikojë editoriale të kohëpaskohshme. (Zija Rexhepi)

KAMENICA (DARDANA). Qytezë në lindje të Kosovës dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Shtrihet në pjesën jugperëndimore të territorit të komunës, në dy anët e lumit Krivareka, në lartësi mbidetare 480 m. Përmendet në disa dokumente të shkruara. Me emrin “Chameniza” përmendet në librin e Mikel Liukarit të shekullit XV, ndërsa në defterin turk të vilajetit Vëllk (1455) përmendet si vendbanim me 18 familje. Në periudhën 1913-1937 në Kamenicë vendosen disa familje kolonësh serbë. Derisa në vitin 1948 kishte 756 banorë, në vitin 2011 në Kamenicë janë regjistruar 7,331 banorë. Në strukturën e



KAMENICA

popullsisë, sipas aktivitetit ekonomik, dominon tregtia, shërbimet, bujqësia e më pak industria. Sistemin arsimor e përbëjnë katër shkolla të mesme (dy në gjuhën shqipe dhe dy të tjera në gjuhën serbe), tri shkolla fillore dhe një institucion parashkollor. Nga objektet e tjera të standardit shoqëror duhet përmendur qendrën e mjekësisë familjare, administratën komunale etj. (Muhamed Kallaba)

KAMENICA (DARDANA) (komuna). Komunë në lindje të Kosovës, në rajonin e Anamoravës. Në përfundim kufizohet me komunën e Gjilanit dhe të Novobërdës, në jugperëndim me komunën e Ranillugut, në veri perëndim me komunën e Prishtinës, në veri me komunën e Medvegjës, në verilindje me komunën e Leskocit, kurse në lindje dhe juglindje me komunën e Vranjës e të Bujanocit. Territori i komunës zë një sipërfaqe prej 417 km², në të cilën jetojnë 36,085 banorë, në 58 vendbanime. Dendësia e banimit është 87 b/km². Me procesin e decentralizimit në vitin 2010, komuna e Kamenicës humbi 182 km² territor, nga i cili u formua komuna e Ranillugut, ndërsa një pjesë iu bashkëngjiti komunës së Novobërdës. Në ndërtimin gjeologjik të kësaj zone marrin pjesë shkëmbinjtë e llojeve dhe moshave të ndryshme: të paleozoikut, paleogjenit, neogjenit dhe të kuaternarit. Dominon relievi fushor dhe kodrinor, ndërsa më pak ai malor. Klima është e mesme kontinentale. Lumi kryesor është Krivareka me degët Desivojca dhe Hogoshti. Territori i komunës është i pasur me antimon, granite, kaolinë, hekur, magnezite, bentonit etj. Në vitin 1455 ishte në kuadër të nahisë së Toplicës dhe të Moravës, ndërsa nga viti 1912 e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore i takonte rrethit të Gjilanit. Statusin e komunës e mori në

vitin 1960. Në aspektin e zhvillimit ekonomik është komunë agrare-blegtorale. Kultivohet gruri, misri, pemët dhe perimet. Fondi i tokave bujqësore është: ara 12, 284 ha (29.4%), kullosa 7,365 ha (17.6%), livadhe 2,842 (6.8%) etj. Repartet e para industriale hapen në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, kur u ndërtua fabrika e pllakave dhe e magnezitit. Sistemi i arsimit përfshin 20 shkolla fillore, prej tyre 17 në gjuhën shqipe dhe 3 në gjuhën serbe; 4 shkolla të mesme dhe dy institucione parashkollore. (Muhamed Kallaba)

KAMENOVIQ Svetozar (1921-1979). Pikturor. Lindi në Pirot (Serbi). Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. U diplomua për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd (1953). Pas studimeve u punësua në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ku punoi deri në fund të jetës si mësimdhënës për lëndët vizatim, pikturë dhe teknologji e pikturës. Hapi disa ekspozita personale, si në Pirot (1953), Pejë (1955, 1972), Prishtinë (1968), Prizren (1974) etj. Mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës: në Prishtinë, Sarajevë, Podgoricë, Suboticë, Katovicë, Banjallukë, Beograd, Zagreb, Tuzëll etj. Ishte fitues i disa çmimeve publike dhe profesionale. Në veprat e tij dominojnë motivet e Pejës, gryka e Rugovës, arkitektura e objekteve të trashëgimisë kulturore-historike, si dhe portretet dukagjinase. I takon frymës liriko-ekspresive, ndërsa në veprat e fundit përfshin një notë abstrakte në peizazhe e figuracion. (Hivzi Muharremi)

KAMIL Ilhami (1944-2015). Gazetar. Lindi në Blatse të Maqedonisë. Shkollimin e nisi në Gostivar, ndërsa studimet për pedagogji i mbaroi në Shkup. Në kohën e studimeve ishte arsimtar i gjuhës në Gostivar dhe redaktor përgjegjës në gazetën "Birlik". Në vitet '70 u vendos në Prishtinë. Nga viti 1974 vazhdoi punën si gazetar, e më pas edhe redaktor i emisioneve në Televizionin e Prishtinës (TVP). Në vitin 1999 u shpërngul në Shkup dhe vazhdoi punën si gazetar në Radiotelevizionin e Shkupit. (Agnesa Rashiti Glloboderi)

KAMPI I PËRQENDRIMIT NË PRISHTINË (1944). Kamp i të burgosurve antifashistë, i ngritur nga gjermanët në Prishtinë në vitin 1944. Aty ishin të vendosur së paku 800 veta,



KAMPI I PËRQENDRIMIT NË PRISHTINË


shumica shqiptarë nga Shqipëria (nga Shkodra 200, Tirana 250 veta), por kishte dhe nga Prishtina, Gjakova, Struga etj. Në kamp kishte edhe serbë, maqedonas, malazezë, kroatë etj. Kampi ishte i rrethuar me dy radhë tela me gjemba afër dy metra të lartë dhe me kulla ku ruanin SS-ët. Kushtet e jetesës ishin të vështira, ndërsa mbi të burgosurit përdroreshin edhe tortura të ndryshme. Sëmundjet ngjithëse ishin të shpeshta, të sëmurët ishin të shumtë, ndërsa ndihmonte vetëm një mjek serb, që edhe ai ishte i burgosur. Shumë të burgosur zhdukeshin pa gjurmë. Historia e Kampit të Prishtinës lidhet me dy masakra të mëdha. E para, më 19 shtator 1944, kur në Qafë-Morinë u ekzekutuan 26 vetë nga ky kamp dhe më 23 tetor 1944, kur u pushkatuan 104 persona, pasi u detyruan ta hapnin vetë gropën e përbashkët, ku u varrosën. Kampi u shkatërrua gjatë tërheqjes së gjermanëve dhe u boshatis brenda tri ditësh, më 10-12 nëntor, kur një eskadrilë aeroplanësh të aleatëve fluturuan mbi kamp dhe njëkohësisht në tokë u hodhën fletushka, ku thuhej se po afronte liria dhe se Gjermania ishte në prag të kapitullimit. Me këtë rast të burgosurit ikën. (Izber Hoti)

KAMPIONATI BOTËROR I HENDBOLLIT PËR JUNIORE "KOSOVA '79". Gjatë viteve '70 dhe '80 Kosova u bë qendër e njohur e hendbollit. Për shkak të arritjeve në këtë sport, në vitin 1979 Kosovës iu besua organizimi i Kampionatit Botëror të Junioreve në Hendboll, "Kosova '79". Kampionati u mbajt prej 13-23 tetor 1979 në qendra të ndryshme të Kosovës. Në këtë kampionat morën pjesë 13 shtete: Austria, BRSS-ja, Danimarka, Franca, Holanda, Hungaria, Italia, Japonia, Jugosllavia, Norvegjia,

RD e Gjermanisë, RF e Gjermanisë dhe SHBA-ja. Në shtatë qendra të Kosovës, në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan u zhvilluan gjithsej 45 ndeshje. Titullin e kampionit e fitoi BRSS-ja. Nënkryetari i Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit, Alberto de San-Roman, e vlerësoi lart punën e mirë që bënë punëtorët sportivë të Kosovës në organizimin e këtij kampionati. (Ejup Llumnica)

KANAQI Tahir (1907-1985). Klerik mysliman, humanist. Lindi në Ostros të Vogël (Krajë). Pas shkollës fillore vijoi mësimet në Medresenë e Shkodrës dhe të Tiranës. Ishte pjesëtar dhe sheh i tarikatisë rufai. Punoi, kryesisht, si imam në disa xhami të Krajës, përkatësisht në fshatrat Arbnes, Qyrjan, Kështenjë dhe në Ostros të Vogël dhe të Madh. Ishte mësues në mejtepe e në kurse kundër analfabetizmit, veprimtar i Bashkësisë Islame në vend. Ishte edhe bejtexhi. T. Kanaqi predikoi islamin si fe të paqes, të mirësisë dhe të dashurisë njerëzore. U shqua për respekt, mirëkuptim dhe harmoni midis besimtarëve të besimeve të ndryshme. Ishte atdhetar arsimdashës dhe personalitet i respektuar jo vetëm në trevat e Krajës, por edhe të Ulqinit, Tivarit, Shkodrës e më gjerë. (Hajrullah Koliqi)

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT. Përmbledhja e normave juridike të pashkruara të së drejtës zakonore të shqiptarëve, të përcjella në traditën gojore të malësorëve, të mbledhura



LEKË DUKAGJINI

drejtëpërdrejt nga goja e popullit, kryesisht në Mirditë, nga Shjefën Gjeçovi, në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Materiali i mbledhur filloi të botohej pjesë-pjesë në revistën "Hylli i Dritës" nga viti 1913 deri në vitin 1929. U kodifikua dhe u botua i plotë në vitin 1933 në Shkodër, si vepër e Shtjefën Gjeçovit, i vrarë nga shovinistët serbë (1929).

Tradita gojore e lidh Kanunin me emrin e Lekë Dukagjinit, bashkëkohës dhe bashkëlufëtari i Skënderbeut. Por mendimet e studiuesve rreth rrolit të Lekë Dukagjinit në këtë kanun janë të ndryshme. Shtjefën Gjeçovi e filloi botimin e materialeve nën titullin "Kanuni i maleve", gjë që mund të shprehë më afër të vërtetën për

gjenezën e tij, ndonëse ende mbetet një tezë e diskutueshme.

Kanuni përmban 12 libra, 24 krerë, 199 nene dhe 1263 paragrafë. Secili kapitull, siç mund të quhen me gjuhën bashkëkohore juridike trajton një çështje që mund të klasifikohen nga e drejta private tek ajo familjare dhe deri te e drejta penale dhe civile. Libri i parë i kushtohet kishës dhe mbrojtjes së pronës së saj; libri i dytë familjes; libri tretë martesës, që nga momenti i njohjes së çiftit e deri te organizimi i ceremonisë, duke përfshirë edhe normat e ndalesës midis kategorive në lidhje gjaku. Libri i katërt mban titullin "Shtëpia, gjaja dhe prona", ndërsa në kapitullin e pestë trajtohen çështje që në gjuhën bashkëkohore moderne mund të klasifikohen si e drejta e punës. Në kapitullin e gjashtë janë "të dhanunat", pra huatë, ndërsa kapitulli i shtatë mban titullin "Fjala e gojës", e cila mund të interpretohet si "premtim" dhe "betim" njëkohësisht. Libri i tetë përbën shtyllën e kanuneve dhe të drejtës zakonore shqiptare, atë që mban lidhjen e këtij kodi dhe e bën të respektueshëm. Në librin e nëntë janë përcaktuar "damet", ndërkaq në librin e dhjetë gjakmarrja, e cila edhe sot në shumë vise shqiptare trajtohet me rregullat e Kanunit.

Normat juridike të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit kanë karakter të dyanshëm: pasqyrojnë marrëdhëniet shoqërore të rendit gjinor, barazinë midis njerëzve, por marrëdhënie të diferencuara ekonomiko-shoqërore, pabarazinë e gruas me burrin etj. Kanuni zbatohet në lloje për të gjithë malësorët, pavarësisht nga besimi fetar. Ai shpreh origjinalitetin e së drejtës zakonore të shqiptarëve dhe ka një shtrat të përbashkët me kanunet e tjera. Ai është monument historik i kulturës popullore në përgjithësi dhe asaj juridike në veçanti. Po ashtu është një koleksion zakonesh dhe normash të ndryshme, që u përkasin gati të gjitha fushave të jetës dhe të veprimtarisë ekonomike e shoqërore të njerëzve. Njëkohësisht përfaqëson edhe një dëshmi të rrugës që kanë kaluar shqiptarët gjatë procesit të zhvillimit historik. Kanuni është përplot zakone të vjetra, të krijuara në etapa të ndryshme të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Ka zakone që u krijuan në shoqërinë pa klasa, në periudhën e ekonomisë gjahtarë, si dhe zakone të etapave të tjera. Nga Kanuni shihet se karakteristika kryesore e shoqërisë ishte patriarkaliteti dhe rendi fisnor. Disa

fise bëjnë një lidhje fisesh, në krye të së cilës gjendet kryepari; fiset ndahen në vëllazëri, të cilat përmenden shumë rrallë në Kanun, ndërsa katundi si organizim ekonomik dhe shoqëror përmendet më shpesh.

Kanuni i Lekë Dukagjinit është përkthyer në shumë gjuhë dhe është bërë objekt studimi nga një varg juristësh dhe etnologësh. (Bashkim Lajçi)

KANUNNAMET E KOSOVËS. Janë kode ligjore osmane, me të cilat shteti osman parashtrori natyrën dhe veçoritë e sundimit të tij në territorin e Kosovës. Përmes kanunnameve shteti osman administroi burimet njerëzore dhe burimet ekonomiko-fiskale që ndodheshin në Kosovë. Kanunnametë ofrojnë informacion të vlefshëm mbi kulturat bujqësore që kultivoheshin, mbi kafshët dhe gjënë e gjallë që mbarështrohej, por edhe për aktivitetet ekonomike rajonale (bletaria, prodhimi i verës) dhe në çmasë ato ishin subjekt i sistemit osman të taksave. Në kanunnametë e xeheroreve të Kosovës (Novobërdës, Trepçës, Janjevës, Bellasicës etj.) gjejmë shënime të vlefshme mbi veprimtarinë e këtyre xeheroreve. Mes veçorive lokale që reflektohen nëpër kanunnametë e Kosovës janë njësitë e masës dhe të peshës, të cilat konvertoheshin sipas atyre të Stambollit. Por në to hasim edhe referenca të vazhdueshme për sistemin paraosman të taksimit (taksa e barit, e dynymit, e druve, e derrave etj.), çka është një dëshmi që kanunnametë osmane aq sa reflektonin veçoritë kanunore paraosmane, po aq shërbenin edhe si dokumente juridike që shpalosin aspekte të transicionit nga periudha paraosmane në atë osmane. Në kanunnametë e sanxhakut të Prizrenit (1570 dhe 1583) kryesisht bëhet fjalë për sistemin e taksimit: të banorëve, të kulturave bujqësore që kultivoheshin, të vreshtave dhe mullinjve. Ndërkaq, në tri kanunnametë e sanxhakut të Vuçitërnës (1525, 1530 dhe 1574-1595), ndryshe nga kanunnametë e Prizrenit, figuron edhe udhërrëfyesi se si procedohej për inspektimin e tregjeve në qytetet që bënin pjesë në këtë sanxhak. Me cilësinë e dokumenteve juridike, kanunnametë kishin karakter normativ. Mënyrën e zbatimit të tyre në terren e mësojmë përmes regjistrave kadastrale osmanë (tahrir defterleri). (Dritan Egro)

KAOLINA. Argjilë me ngjyrë të bardhë, e përbërë kryesisht nga minerali argjilor i kaolinit,

me përzierje të kokrrizave të mineraleve të tjera argjilore, kuarcit etj. Kaoliniti është një produkt i tjetërsimit të shkëmbinjve me përmbajtje të feldshpateve dhe mikave, si: granitet, granodioritet, gabrot, gneisët. Vendburim me rëndësi i kaolinës në Kosovë gjendet në Karaçevën e Ulët, në lindje të Kamenicës. Gjenetikiisht, kaolina është formuar përmes tjetërsimit të granodioriteve të Bujanocit dhe mund të konsiderohet si parësore. Deri më tani është shfrytëzuar një sasi e konsiderueshme e këtij vendburimi. Rezerva të hulumtuara mirë tregojnë se kanë mbetur edhe 1,9 milion m³, ndërsa rreth 12 milionë m³ janë në perspektivë. Kaolina përdoret kryesisht për prodhimin e porcelanit, por fabrika e vetme e Kosovës në Kamenicë tashmë është mbyllur. Përveç vendburimit të Karaçevës, kaolina shfaqet edhe në dy lokacione të vogla në Badovc, rreth 10 km në juglindje të Prishtinës. (Behxhet Shala)

KAPITI Skënder (1950-). Piktur. Lindi në Prishtinë. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet për pikturë i mbaroi në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1980). Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe pjesëmarrës në ekspozitat e saj tradicionale, në vend dhe jashtë. Ndër ekspozitat personale veçohen: më 1993 në Qendrën Kulturore Shqiptare "Faik Konica" në Londër; më 1995 në Central Broomley Galeri në Londër; më 1998 "Java e refugjatëve" në Central Library (Londër) dhe më 1998 Lewisham Theatre po në Londër. Mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta më 1986 "20 vjet të Fazitës" në Galerinë e Arteve të Kosovës (GAK) në Prishtinë më 1987, "Salloni i të rinjve" në GAK, pastaj në Sallonin Pranveror të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës më 1993, pastaj në ekspozitën "5th Levisham Visual Arts Festival" në Londër (1995) dhe më 1998-1999 në "Kosova dje, sot, nesër" në Galerinë "Kufa" po në Londër. Jeton dhe krijon në Britani të Madhe. (Tahir Emra)

KAPROLI. (*Capreolus capreolus* L) Është specia më e rëndësishme e kafshëve të egra në Kosovë. Ekziston në terrene fushore, kodrinore dhe në brezin malor. Mashkulli ka gjatësi trupore 120-140 cm, lartësi 70-75 cm, me peshë të ndryshme nga 25-35 kg. Femra është 5-10% më e lehtë se mashkulli. Pëlqen pyje të përziera, me formacione shkurrishte, kullota

dhe livadhe. Përshtatet shumë mirë edhe në tokë të punueshme me kultura bujqësore dhe formacione të trasha bari, ku ka kushte të mira për mbijetesë. Ushqehet kryesisht me baroja, me bisqe dhe gjethe, ndërsa dimrit edhe me lëvore të filizërisë dhe të degëve. Çiftëzimi ndodh nga mesi i korrikut deri nga mesi i gushtit. Femra lind një ose dy, rrallë dhe tre të vegjël. Brirët e përpunuar të kaprollit konsiderohen si trofe. (Ibrahim Muja)

KARADAKU. Mal në juglindje të Kosovës. Gjendet në trekëndëshin Kosovë-Maqedoni-Serbi (Lugina e Preshevës). Ka shtrirje jug-perëndim-verilindje. Karadaku apo Mali i Zi i



PAMJE NGA KARADAKU

Shkupit (turq. Karadag-Mal i zi) shtrihet ndërmyet fushës së Moravës së Binçës dhe grykës së Konçulit në veri, Grykës së Kaçanikut në perëndim, Luginës së Preshevës në lindje dhe fushëgropës së Shkupit në jug. Tipar kryesor i morfologjisë së relievit malor është copëtimi i madh horizontal dhe energjia e relievit. Lumenjtë, me luginat e thella, që në disa sektorë marrin tiparet e kanioneve, kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në modelimin e relievit të Karadakut. Pika më e lartë është Ramno (1,651 m). Nga majat e tjera veçohen: Maja e Zezë (1,219 m), Kopilaça (1,492 m), Ostrovica (1,164 m) etj. Gryka e lumit të Lipkovës, i cili buron nga malet e Karadakut, në aspektin morfologjik është e ndarë në pjesën perëndimore, e cila është më e lartë, dhe pjesën lindore, që është më e ulët. Në aspektin gjeografik, Karadaku ndahet në: Karadakun e Shkupit, Karadakun e Kumanovës e të Preshevës dhe Karadakun e Gjilanit. Klima e kësaj zone dallohet për dimër të ashpër me borë dhe verë të freskët dhe të thatë. Mbulesa bimore përfshin rreth 50%

të sipërfaqes, kryesisht dushk dhe ah. Paraqet një trevë etnografike shqiptare me strukturë monolite etnike dhe me dominim absolut të popullsisë shqiptare. Vendbanimet e Karadakut si në Kosovë, në Maqedoni dhe në Luginë të Preshevës janë përfshirë nga valët intensive të shpopullimit. Izolimi i gjatë, mungesa e infrastrukturës dhe e objekteve të standardit shoqëror, si dhe konfliktet e armatosura, kanë qenë shkaktarët kryesorë të shpopullimit. Sot shumë vendbanime të Karadakut kanë mbetur vetëm emërtime gjeografike. (Arsim Ejupi)

KARAGA Adem (1975-). Aktor. Lindi në Kërçovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, kurse studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Disa nga



ADEM KARAGA

shfaqjet ku ka pasur rolet më të realizuar janë: “Balada e urtisë” me regji të F. Hysaj, “Repriza e lirisë” me regji të E. Brajshorit, “Hamleti” të S. Nuredinit, “Mbreti Edip” me regji të A. Jakupit, “Akuarium” me regji të K. Bektshit, “Kapela e bardhë” me regji të O. Mazes, “Xhaxh Vanja” me regji të S. Unkovskit, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” me regji të D. Mustafiqit. Ka aktruar edhe në filmat “Shi në gjak” dhe “Koha e kometës”. Është fitues i disa çmimeve për aktrim. Për rolin e Abelit në shfaqjen “Repriza e lirisë” fitoi çmimin e aktorit më të mirë në festivalet për teatër në Gjilan, Dibër dhe çmimin “Aleksandër Moisiu” në Tiranë, kurse si aktor më i mirë u shpërblye edhe për interpretimin në shfaqjen “Balada e urtisë”. Për shkak të veprimtarisë politike ka bërë disa vjet burg. Veçohet për fjalën e pastër dhe diksionin e veçantë. (Salajdin Salihu)

KARAGIQI Imzot Pjetër (1648-1727). Argjipeshkëv i Shkupit. Lindi në Novobërdë, mësimet fillestare i kreu në Janjevë dhe i vazhdoi në rezidencën e kryepeshkëvit Andrea Bogdani. Në vitin 1666 shkoi për studime në Kolegjin Ilirik të Loretos. Për shkaqe shëndetësore e braktisi kolegjin dhe vazhdoi mësimet në rezidencën e Pjetër Bogdanit, ku u diplomua në lëmin e gramatikës dhe kauzistikës. Shërbeu në Trepçë e gjetiu. Në vitin 1672, Papa Klementi XI e emëroi kryepeshkëv

të Shkupit. Gjatë asaj kohe krypeshkvijtë e Shkupit ishin të përndjekur nga Perandoria Osmane. Për çështje sigurie, u strehua në Zym të Hasit, por Shkupi vazhdonte të njihej si qendër ipeshkvnore. Bashkë me imzot Vinçent Zmajeviqin, me mbështetjen e Papës Klementit XI, organizuan Kuvendin e Arbërit (1703), ku Karagiqi gjithashtu mori pjesë. Vdiq dhe u varros në Zym. (Frrok Kristaj)

KARAHODA Nexhat (1932-2011). Lindi në Prizren. Kreu gjimnazin në Prishtinë, studimet i mbaroi në Fakultetin e Pylltarisë të Universitetit të Beogradit (1958). Kreu specializimin nga fusha e mbrojtjes së ambientit në Çekosllovakia. Punoi specialist i pyjeve në Prizren dhe për shumë vjet në Sekretariatit Krahinor të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave. U mor me mbrojtjen e ambientit dhe të hortikulturës. Botoi punime profesionale dhe mori pjesë në shumë tubime shkencore në vend dhe në botën e jashtme. Dha kontribut në zhvillimin e pyjeve si ekspert i parë i kësaj fushe në Kosovë. (Ibrahim Muja)

KARAHODA Skender (1941-). Mjek stomatolog, profesor universiteti. Lindi në Prizren. Kreu arsimin fillor dhe të mesëm në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1962). Punoi si stomatolog në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë. Ishte i punësuar i parë në seksionin e stomatologjisë të Fakultetit të Mjekësisë. Specializimin nga lëmi i protetikës e përfundoi në Beograd, ku kreu dhe studimet pasuniversitare. Mbrojti disertacionin e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1980). U zgjodh asistent i lëndës së protetikës stomatologjike në vitin 1979, më pas u avancua në të gjithë titujt universitarë. Për shumë vjet ishte shef i Klinikës së Protetikës Stomatologjike, drejtor i seksionit të stomatologjisë, prodekan i Fakultetit të Mjekësisë dhe rektor i Universitetit të Prishtinës (1989-1991). Gjatë viteve '90 u bë krah i proceseve që mbështetnin politikën e Serbis në Kosovë. Jeton në Novi-Sad. (Fatmir Dragidella)

KARAHODA Veli (1968-). Poet, prozator, eseist. Lindi në Prizren. Shkollimin fillor dhe të mesëm i përfundoi në Prizren, u diplomua në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1991). Në shtypin shqiptar paraqi-

tet në fund të viteve '80 me botimin e eseve që trajtojnë tema të ndryshme letrare, filozofike e politike. Gjithashtu botoi poezi, tregime dhe kritikë letrare në gazetën "Rilindja", "Flaka e vëllazërimit" dhe në revistat "Jeta e re", "Fjala", "Zëri" etj. Veprat letrare i nisi me romanin "Kështjella shqip e Kafkës" (1991), duke vazhduar me përmbledhjet poetike "Klepsidra e verdhë" (1992) dhe "Akademia e veshjes bukur" (1993). Pastaj botoi veprat me tregime dhe novela "Balsamuesit e luleve" (1994) dhe "Lukrecia" (1995), duke vazhduar me romanet "Demonët" (2000), "Shtatë fjalët e fundit" (2003) dhe "Serpenti dhe Hija" (2015). Për veprën letrare u nderua me disa çmime nacionale të Kosovës. Ka botuar edhe veprën eseistike "Panairi i kufomave" (1992). V. Karahoda në letërsinë shqipe sjell frymën e syrealizimit me intencë të shkrimit intertekstual me frymën postmoderne. Vepra e tij sjell shumëzëshmërinë simboliste e narrative, për t'u shquar si vepër kontemplative e intelektualiste. V. Karahoda jeton e punon në qytetin Odense në Danimarkë. (Nysret Krasniqi)

KARAHODA-GJURGJEALA Natyra (1950-). Mjeke, fiziologe, profesore universiteti. Lindi në Prizren, shkollimin bazë dhe Fakultetin e Mjekësisë i kreu në Prishtinë (1969).



NATYRA
KARAHODA-
GJURGJEALA

Gjatë studimeve punoi si demonstratore në Institutin e Fiziologjisë në Prishtinë. Pas diplomimit u zgjodh asistente në lëndën e fiziologjisë mjekësore. Gjithashtu në Prishtinë kreu specializimin nga mjekësia e punës. Më 1981 kreu studimet e magjistraturës në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, ndërsa më 1987 mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe mori titullin docent. Në vitin 1993 u zgjodh profesore inordinare për lëndën e fiziologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më pas titullin profesore e rregullt. Gjatë viteve '90 punoi në sistemin paralel të institucioneve të arsimit të lartë. Ka qenë drejtoreshë e Institutit të Fiziologjisë prej 1999-2010. Pas luftës ka qenë prodekane për mësim në Fakultetin e Mjekësisë, si dhe drejtuese disavjeçare e degëve infermieri dhe mami dhe ka kryer

detyra të ndryshme në sistemin e arsimit universitar. Ka botuar një sërë punimesh shkencore, si autore dhe bashkautore dhe është bashkautore e një teksti universitar. (Halil Ahmetaj)

KARAXHIQ Vuk Stefanoviq (Stefanović Karadžić) (1787-1864). Filolog, folklorist, leksikograf serb. Lindi në Tërshiq, Serbi. Në vitin 1814 botoi në Vjenë dy libra: “Këndonjëtoje e vogël me vjersha popullore sllavo-serbe” (Mala prostonarodna slaveno-serpska pjesnarica) dhe “Shkronjëtoje e gjuhës serbe” (Pismenica serpskoga vezika po govoru prostoga naroda napisanu), që është gramatika e parë e gjuhës serbe. Më 1918 botoi Fjalorin e gjuhës serbe me 26,270 fjalë. Ky fjalor konsiderohet si veper e parë e reformës së drejtshkrimit dhe e vendosjes së cirilikës. Krijoi alfabetin e gjuhës serbe, në të cilin secilit tingull i përgjigjet një shkronjë. Në gjuhën popullore serbe e përktheu “Dhiatën e Re” (1847). U interesua dhe për gjuhën shqipe. Mblodhi 13 këngë popullore shqipe nga fshati Gjurakocv në nahinë e Pejës. (Naile Mala-Imami)

KARJAGDIU Abdullah (1936-). Filolog, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Prizren. U diplomua për gjuhë e letërsi angleze në Beograd (1961), magjistroi në Zagreb, ndërsa doktoroi në vitin 1975 në Universitetin e Prishtinës (UP). Një kohë punoi mësimdhënës i anglishtes, i frëngjishtes dhe i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të Prizrenit, pastaj në gazetën e përditshme “Rilindja”. Ishte ligjërues i anglishtes dhe frëngjishtes në Fakultetin Juridik-Ekonomik të UP-së, ndërsa nga viti 1972 ishte ligjërues e profesor i letërsisë angleze e amerikane, i letërsisë së krahasuar dhe botërore, i teorisë dhe praktikës së përkthimit etj. në Fakultetin Filozofik, përkatësisht në Fakultetin e Filologjisë të UP-së, ku më 2003 mori titullin profesor emeritus. Gjithashtu ka mbajtur mësim në Universitetin e Stambollit, të Tetovës dhe në disa universitete private. Ka botuar veprat: “Historia e gazetarisë” (1963), “Shekspiri në gjuhën shqipe” (1972), “Bajroni dhe shqiptarët” (1975), “Si të përkthejmë” (1975), “Bilinguizmi si problem botëror” (1976), “Ç’është kritika letrare?” (1977) “Me Konicën në Evropë” (1993), “Hyrje në studimet angleze” (anglisht, 1996), “Një pasqyrë e letërsisë angleze” (anglisht, 2005), “Shkrimi akademik” (anglisht 2007). Ka përkthyer “Auto-

biografinë” e Nolit (nga anglishtja), pastaj “Historia e shkurtër e Shqipërisë” (nga rusishtja) të Senkejeviçit dhe autorë të tjerë, “Skënderbeun” e Paganelit (nga frëngjishtja), “Shqipëria, kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” të Konicës, “Kosova, një histori e shkurtër” të N. Malkolmit, si dhe një sërë romanesh, dramash, tregimesh e poezish nga autorë të ndryshëm botërorë. (Eqrem Basha)

KARJAGDIU Lirak (1969-). Studiuues i letërsisë, mësimdhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm. Studimet themelore i kreu në Fakultetin e Filologjisë, ku i mbaroi edhe ato pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës. Punoi si mësimdhënës i gjuhës angleze në shkollë të mesme në Prishtinë dhe përkthyes e zyrtar i OSBE-së, më pastaj mësimdhënës i letërsisë angleze në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ka botuar librat me studime letrare: “Fati i Heminguejit në kulturën shqiptare” (2005), “Thesaret e letërsive anglo-amerikane në gjuhën shqipe” (2008), “Autorë të letërsisë moderne angleze në gjuhën shqipe” (2010). Është autor edhe i disa artikujve studimorë të botuar në revista ndërkombëtare. (Adil Olluri)

KARSTI. Dukuri të zhvilluara me anë të proceseve natyrore, në të cilën dominon tretja e shkëmbinjve nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, me ç’rast formohen forma relievore karstike në brendi dhe në sipërfaqe të Tokës. Terrenet karstike në Kosovë përfshijnë kryesisht shkëmbinj karbonatikë (gëlqerorë, mermerë, dolomitë). Dukuritë karstike në Kosovë janë të pakta, në krahasim me vendet që shtrihen përgjatë Krahinës Dinarike. Terrenet karstike në Kosovë paraqiten me sipërfaqe relativisht të vogla, në trajtë oazash dhe në lartësi absolute prej 600-2,500 m. Sipërfaqja e terreneve karstike në Kosovë është 1,425 km², ose rreth 13% e territorit. Terrenet karstike gjenden në Bjeshkët e Nemuna (Hajlë, Rusoli, Strellc, Neqinat, pjesërisht në Deçan dhe në Junik) dhe në malin Mokna. Në Bjeshkët e Nemuna ndodhen 42.3% e terreneve karstike të Kosovës. Pashtriku, Koritniku etj., janë kryesisht karstikë. Po ashtu, terrenet karstike hasen në horstin e Dukagjinit (Malet e Milanovcit, Zatriqit, Gajrakut, Grebnikut, Llapushës etj.). Në Malet e Sharrit terrenet karstike janë më të pakta, në trajtë oazash

dhe thjerrëzash. Një pjesë ndodhet në pellgun e lumit të Plavës, mali Cvilen, Oshlak, Zhar. Disa thjerrëza gjenden në malet e Jezercit dhe të Nerodimes. Në Malet Qendrore (Carralëvë, Drenicë, Kosmaç) po ashtu paraqiten në trajtë oazash. Në pjesën lindore të Kosovës paraqiten në formë thjerrëzash në afërsi të Gjilanit, në pellgun e Krivarekës, në afërsi të Gadimes dhe rreth luginës së Ibrit në veri. Shkëmbinjtë karbonatikë në Kosovë janë të moshës paleozoike dhe mesozoike (88.3%). Karbonatikët e mesozoikut janë masivë, shtresorë, në disa raste të mermerizuar.

Terrenet karstike në përgjithësi karakterizohen me relief të thepisur dhe hidrografi sipërfaqësore të varfër. Veçohen me forma sipërfaqësore (hurdha, puse të gurit, skriba, lugina karstike etj.), ndërsa format më tipike nëntokësore janë shpellat dhe humnerat (Shpella e Mermertë e Gadimes, Shpella e Radavcit, Kisha e Madhe dhe e Vogël, Shpella e Azem Galicës, e Dushit, e Ponorcit, Humnera e Zgatarit etj.) Me terrenet karstike lidhen burime të fuqishme, gurrat. Gurrat më të njohura janë: e Radavcit, e Vrellës, e Istogut, e Vërmicës etj. (Ruzhdi Pllana)

KASABATË. Qyteza të periudhës osmane. Statusin e kasabasë e kanë marrë ato vendbanime joubane, në të cilat është ndërtuar një xhami me mejtep, një hamam me ujësjellës dhe kana-



NJË RRUGË E VJETËR E PRIZRENIT

lizim, një çarshi me disa dyqane, një han dhe eventualisht një imaret dhe një zavije apo teqe.

Në Kosovë kasabatë janë paraqitur nga gjysma e parë e shek. XVI. Kasabatë kosovare në periudhën osmane janë zhvilluar sipas principeve urbanistike orientale islame, ku xhamia ishte objekti qendror, ndërsa përreth saj ngriheshin objektet e tjera. Kasabatë në Kosovë janë ndërtuar në ato vende, ku ka pasur mundësi të qarkullimit të karvanëve tregtarë, mundësi të mbrojtjes, ku ka pasur ujë të rrjedhshëm etj. Kronologjia e ndërtimit të objekteve të rëndësishme të karakterit sakral dhe profan, si dhe vakëfnametë e publikuara dokumentojnë se kasabaja më e vjetër në Kosovë është Zinova në kazanë e Opojës (Brodosana e sotme). Statusin e kasabasë Zinova e ka fituar në vitin 1538, me ndërtimin dhe vakufimin e xhamisë me mejtep dhe bibliotekë, hamamit me ujësjellës, karvansarajit, namazgjahut dhe çezmës nga Mehmet Kukli beu. Ndërkaq, Rogova e ka fituar statusin e kasabasë në vitin 1581, me ndërtimin e xhamisë me mejtep, hamamit me ujësjellës, imaretit, karvansarajit, kullës, urës, çezmave dhe dyqaneve nga sadriazemi Hasan Pashë Jemishçiu. Gjakova e ka fituar statusin e kasabasë në vitin 1594, me ndërtimin dhe vakëfimin e xhamisë, mejtepit me bibliotekë, muvakit-hanes (objekt për matjen e kohës dhe për caktimin e kalendarit me ndihmën e kuadranteve astrolabike), hamamit me ujësjellës, hanit dhe disa dyqaneve, ndërtuar nga Sylejman Hadim aga. Kaçaniku ka marrë statusin e kasabasë në vitin 1594, kur sadriazemi Koxha Sinan Pasha ndërtoi aty xhaminë, një hamam, një mejtep, një imaret, dy hane dhe kalanë. Gjilani filloi të zhvillohet si kasaba me ndërtimet e objekteve dhe institucioneve të ndryshme, që kanë bërë pinjollë të oxhakut Gjinolli në gjysmën e parë të shek. XVIII. Themelues i kësaj kasabaje konsiderohet Bahtijar bej Gjinolli. Objektet e para që ai ngriti në Gjilan, ishin saraji dhe një kullë mbrojtëse. Përreth tyre Gjinollët kanë ngritur objektet dhe institucionet kryesore që kanë formuar kasabanë e Gjilanit, siç ishin xhamia e vjetër, hamami me ujësjellës, çarshia me dyqanet e para, kulla e sahatit dhe themelat e tjera sociale, ekonomike, arsimore dhe fetare. Ferizaj si vendbanim është formuar si rezultat i zhvillimit të komunikacionit hekurudhor, filimisht si aglomerat rrugor, në gjysmën e dytë të shek. XIX. Vendbanimi ka marrë emrin sipas Feriz Shashivarit, i cili aty kishte ndërtuar hanin e tij dhe objekte të tjera. Ka pasur kasaba në Kosovë, të cilat për arsye të ndryshme nuk

kanë pasur një zhvillim progresiv dhe me kalimin e kohës kanë humbur këtë status. Vendbanime të këtilla kanë qenë Zinova e Opojës dhe Rogova e Hasit. (Nehat Krasniqi)

KASAPOLLI Afrim (1949-). Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet për aktrim i filloi në Akademinë e Arteve në Beograd dhe i përfundoi në Prishtinë, në



AFRIM KASAPOLLI

Shkollën e Lartë Pedagogjike (1969). Po këtë vit në Teatrin Popullor Krahinor nisi karrierën prej aktori. Interpretoi role të shumta në shfaqjet e TPK-së: “Engjëlli i stacionit” (1969), “Sfinga e gjallë” (1976), “Varka e Noes” (1978), “Përqaftimi” (1981), “Spiuni” (1981), “Verbimi i Samsonit” (1982), “Milionerët” (1983) etj. Me role të rëndësishme luajti edhe në shfaqjet: “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Lkeni i Hasit”, “Krushqit janë të ngrirë” etj. Karrierën e aktorit e vazhdoi edhe pas vitit 1999 me shfaqjet: “Trenat”, “Njeriu që pa vdekjen me sy”, “Oda në Hamburg”, “Dredhëza mbi varre”, “Liria po vjen”, “Kosova, ndërgegjja jonë”, “Fundi i Lojes”, “Udhësi i majës së lartë” (2004), “Darka publike” (2010), “Shtëpia në ankand” (2012), “Vorbulla” (2014) etj. Interpretoi edhe në gjuhën serbokroate në shfaqjet “Dundo Maroje” (1973) dhe “Otello” (1974) etj. Përveç në teatër dhe në televizion, si aktor luajti edhe në filmat artistikë: “Kur pranvera vonohet” (1980), “Buka e hidhur” (1996), “Mirushi” (produksion norvegjez, 2007), “Dossier K” (produksion belg, 2009). Në vitin 2005, si regjisor ka realizuar shfaqjen “Oda në Hamburg” me tekst të T. Dervishit (2005). (Arian Krasniqi)

KASAPOLLI Agim (1945-). Basketbollist, trajner, gazetar i sportit. Lindi në Pejë. Që nga moshë 18-vjeçare derisa ishte lojtar aktiv i basketbollit, anëtar i “Buduqnostit” në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. 35 herë i mbrojti ngjyrat e përfaqësueses së Kosovës në basketboll. Pas përfundimit të Fakultetit të Kulturës Fizike dha provimin për gjyqtar federativ, e më pas kreu edhe Shkollën e Lartë të Trajnerëve në Zagreb. Më 1981 u bë trajner i KB “Universiteti” të Prishtinës. Pas suksesit që shënoi me “Universitetin”, më 1982 Shoqata e Trajnerëve të Jugosllavisë ia ndau titullin e trajnerit më



AGIM KASAPOLLI


të suksesshëm. Më 2001 u emërua përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës, ku qëndroi për dy vjet. Po këtë detyrë e ushtroi edhe gjatë viteve 2010, 2011. Krahas basketbollit, u mor edhe me gazetari sportive. Në periudhën 1974-1980 ishte gazetar i gazetës kroate “Sportske novosti” të Zagrebit. Punoi si gazetar i Televizionit të Prishtinës (1976-1990), ndërsa pas luftës (1999-2003) rikthehet në Radiotelevizion e Kosovës. Gjatë viteve ’90 punoi në gazetën “Bota sot”. Për punën 40-vjeçare në gazetarinë sportive u nderua me çmime dhe mirënjohje, përfshirë edhe çmimin “Anton Mazrreku” (2004). (Rifat Gjonbalaj)

KASAPOLLI Halit (1937-1959). Kompozitor, mësimdhënës i muzikës. Lindi në Pejë. Talentin muzikor dhe prirjen prej kompozitori e shfaqti qysh gjatë Shkollës së Mesme të Muzikës në Prizren në vitet 1954-1958. Në ato vite ka përpunuar këngë korale mbi tema popullore, por edhe ndonjë orkestrale (“Vallja shqiptare”, fantazia “Pranvera”), si dhe vokalo-instrumentale (“Hasan aga”, për solistë, kor e orkestër). Me të mbaruar shkollën e mesme të muzikës, në vjeshtë të vitit 1958 u pranua në Akademinë e Muzikës në Beograd. Vdekja e hershme nuk ia bëri të mundur t’i realizojë nismat e suksesshme prej kompozitori. (Zeqirja Ballata)

KASAPOLLI Jakup (1944-). Punëtor sportiv. Lindi në Pejë. Shkollimin fillor e të mesëm i kreu në vendlindje, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, grupin për kulturë fizike, kurse Fakultetin e Kulturës Fizike e kreu në Sarajevë (1976). Si basketbollist filloi në “Buduqnost” të Pejës, pastaj luajti në KB “Trepça” të Mitrovicës. Më 1970 në Pejë themeloi klubin e basketbollit “Partizani”, por për arsye politike veprimtaria e klubit u ndërpre më 1972. Në vitin 1977 merr titullin e gjyqtarit të kategorisë federative. Një kohë ishte trajner i hendbollit në KH “Ramiz Sadiku”, ndërsa më vonë punoi me grupmosha të reja në shkollat e pingpongut, notit e basketbollit. Në fillim të botimit të gazetës “Koha ditore” punoi edhe si gazetar i sportit. Në vitin 2000 themeloi klubin

e basketbollit “Penza” (femrat), ku veproi si trajner dhe zëvendëstranjer deri në vitin 2012. Në vitin 2005 botoi librin në dy vëllime “75 vjet të sportit në Pejë”. Kreu detyra të ndryshme në organizimet sportive, në shoqata dhe asociacione të ndryshme në nivel të Kosovës dhe të komunës së Pejës. (Xhavit Kajtazi)

KASAPOLLI Shemsedin (1929-2006). Piktor. Lindi në Pejë. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të arteve, studimet themelore dhe ato pasuniversitare



SHEMSEDIN
KASAPOLLI

në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd. Është i njohur si krijues i figuracionit abstrakt, i një realiteti mistik. Pas studimeve u punësua në një shkollë fillore në Beograd. Në atë periudhë u mor me ilustrime, që u botuan në periodikun dhe në gazetën ditore. Bëri edhe ilustrime të librave të ndryshëm. Në vitin 1976 u kthye në Kosovë dhe filloi punën si mësimdhënës i metodikës së artit figurativ në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Me hapjen e Akademisë së Arteve në Universitetin e Prishtinës, u angazhua po për lëndën e metodikës, ku punoi deri në pensionim. Hapi disa ekspozita personale: në Pejë më 1959, në Beograd më 1971 etj. si dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive të organizuara nga Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës. (Hajrush Fazliu)

KAZER Karl (1954-). Historian austriak dhe antropolog i historisë. Lindi në afërsi të Gracit, në Austri. Kreu studimet për histori në Universitetin e Gracit, ku më vonë mbaroi edhe doktoratën (1980) dhe habilitimin (1986). Prej vitit 1980 u angazhua mësimdhënës, ndërsa në vitin 1996 u emërua profesor i rregullt për histori të Europës Juglindore dhe drejtor i Qendrës për Histori dhe Antropologji të Europës Juglindore (SEEHA) në Institutin e Historisë të Universitetit të Gracit. Në vitin 2012 përmbloodhi punën njëzetvjeçare të hulumtimeve mbi familjen në Ballkan në botimin “Ekonomia familjare dhe familja në Ballkan”, ku janë përfshirë edhe hulumtimet për familjen shqiptare. Publikimet e tij viteve të fundit janë: “Kultura vizuale në Ballkan dhe në Lindjen e Afërt” (2013), “Ballkani dhe Lindja

e Afërt. Hyrje në një histori të përbashkët” (2011), “Patriarkat pas Patriarkati. Relacionet gjinore në Turqi dhe në Ballkan 1500-2000” (2008) etj. Jeton dhe vepron në Grac, si profesor dhe udhëheqës i SEEHA-së në Universitetin e Gracit. (Elife Krasniqi)

KASTELAN Zhorzh (George Castellan) (1920-). Historian francez, profesor në Universitetin e Parisit (Sorbonë) për historinë bashkëkohore të Ballkanit, të Polonisë dhe të Europës Qendrore. Është autor i një varg botimesh për historinë e Shqipërisë. Për veprimtarinë dhe arritjet e tij shkencore ka marrë çmime dhe titullin “Doctor honoris causa” nga universitete dhe akademi të vendeve të ndryshme, si dhe nga Shoqata Franceze për Historinë Moderne. Është nënkryetar nderi i Shoqatës të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE). Nga veprat e tij është përkthyer dhe botuar shqip “Histori e Ballkanit (shek. XIV-XX)” (Tiranë, 1996), në të cilën trajtohet edhe historia e Shqipërisë. Për historinë e Shqipërisë shkroi edhe një vëllim të veçantë me titull “Shqipëria” (L’Albanie, 1980), që i drejtohej lexuesit të huaj, në radhë të parë atij francez. Në të janë trajtuar aspektet themelore të historisë së popullit shqiptar, që nga lashtësia deri në ditët e sotme. U ribotua më 2002 me titull “Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve” (Histoire de l’Albanie et des Albanais). (Fitim Rifati)

KASTRATI Adem (1930-2000). Pikturor. Lindi në Karaçevë të Epërme të Kamenicës. Punoi si arsimtar i artit figurativ në tetëvjeçare të Anamoravës së Poshtme (Gjilan e Ferizaj).



ADEM KASTRATI

Pasi kreu Akademinë Pedagogjike (drejtimi i artit figurativ) në Shkup (1965), u punësua në gjimnazin “Zef Lush Marku”, ku qëndroi deri në pension. Krahas punës pedagogjike vizatoi e pikturoi në teknikën e akuarelit natyra të qeta e peizazhe. Duke e parë se dheu i vendlindjes ishte i pasur me ngjyra të llojllojshme, filloi t’i përziejë me emulzione dhe të pikturojë me to. Këtë teknikë me ngjyra dheu e përsosi deri në atë shkallë, sa u bë ndër krijuesit më origjinalë të ne. Ishte krijues i përkushtuar dhe

i qartë, që gjermonte me brushën e tij dheun e vendlindjes, duke krijuar peizazhe e enteriere nga jeta e fshatit. U bë i njohur me portrete, nudo e tablo me motive autoktone. Hapi disa ekspozita personale dhe mori pjesë në shumë ekspozita kolektive të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1958, ndërsa të Maqedonisë nga viti 1965. Mori një sërë çmimesh dhe mirënjohesh në manifestime të shumta artistike brenda dhe jashtë vendit. Veprat e tij gjenden në muze, galeri e koleksione private në vend dhe në botë. (Blerim Luzha)


KASTRATI Ali (1919-2013). Boksier, mundës, peshëngritës, trajner. Lindi në fshatin Korroticë të Preshevës. Shkollën fillore e kreu në Tiranë më 1938, ku në vitin 1940 nis karrierën e boksierit. Bëri emër pas meçeve me ish-kampionin e Italisë Mario Deniskën (1943), me kampionin e Gjermanisë Hufs Jan (1944) dhe me kampionin e Shqipërisë, Rafael Dishnicën. Karrierën e vazhdoi me shumë fitore në Bullgari, Poloni dhe në Çekoslovakia. Mbrojtí ngjyrat e kombëtares shqiptare në boks 20 herë dhe shënoi 18 fitore. Zhvilloi mbi 300 meçe dhe katër herë u stolis me titullin e kampionit shtetëror. Kastrati ishte edhe peshëngritës. U shpall kampion i Shqipërisë në vitin 1949, me 20 rekorde shtetërore (1949-1966). Në po këtë sport ishte trajner i "Partizanit" dhe i kombëtares shqiptare, fitues i 18 kampionateve kombëtare dhe i gjithë kupave të Republikës (1949-1966). Ndërsa në sportin e mundjes gjatë periudhës së viteve 1951-1966, A. Kastrati ishte pesë herë kampion kombëtar në kategorinë e mesme (1949-1954). Gjatë karrierës në tri sporte (boks, mundje dhe peshëngritje) fitoi 65 medalje. Kastrati u zgjodh në mesin e 12 sportistëve më të shquar shqiptarë të të gjitha kohëve (1998) dhe ishte bartës i titujve "Mjeshtër i Merituar", "Trajner i Merituar", "Mjeshtër i Madh", Urdhri i Artë "Naim Frashëri", "Urdhri i Skënderbeut" dhe me medaljen "Nderi i Sportit Shqiptar". Vdiq në Tiranë. (Xhavit Kajtazi)

KASTRATI Arben (1967-). Aktor, regjisor. Lindi në Shkup. Kreu aktrimin në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Studimet i vazhdoi edhe në "Juliard School" në Nju-Jork dhe në "Insas University" në Bruksel. Veprimtaria e tij si aktor filloi në Teatrin "Dodona" në Prishtinë dhe vazhdoi në Teatrin

Kombëtar, ku gjatë viteve 2001-2003 punoi si menaxher i këtij teatri. Suksesi më i madh i tij si aktor lidhet me filmin "Para shiut" i regjisorit M. Mancevski, fitues i Festivalit të Venecias. U paraqit edhe në një sërë projektsh televizive, radiodrama dhe filma dokumentarë. Po ashtu u provua edhe si autor i dramave dhe romanit. Në vitet 2005-2014 ishte kolumnist i shpeshtë në gazeta ditore që botoheshin në Kosovë dhe Shqipëri. Shkroi tekstin dhe bëri regjinë e shfaqjes "E di që kam pasur një titull më të mirë, por e kam harruar" (2004). (Jeton Budima)

KASTRATI Bekim (1971-2001). Gazetar. Lindi në Polluzhë të Drenasit. Arsimin fillor dhe të mesëm e përfundoi në vendlindje, ndërsa studimet për blegtori në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1996 u inkuadrua në radhët e UÇK-së, për të vazhduar deri në përfundim të luftës. Ishte ushtar në Brigadën 113 "Mujë Krasniqi". Bashkëpunoi si korrespondent i gazetave "Dardania", "Pasqyra", "Kosova sot" dhe "Bota sot". Ishte bashkëpunëtor edhe i revistës lokale "Shkëdijat e Drenicës" në Skënderaj. U vra më 2001 afër Skënderajt. (Bajrush Morina)

KASTRATI Beqir (1911-1989). Veprimtar dhe veteran i arsimit. Lindi në Pejë, ku kreu edhe dy klasë të fillores shqipe. Për shkaqe politike, bashkë me familjen, emigroi në Shqipëri.



BEQIR KASTRATI

Vazhdoi gjimnazin në Shkodër, ndërsa diplomoi në degën e Normales. Në vitin shkollor 1932/33 emërohet mësues në shkollën fillore në Krumë të Hasit. Deri në vitin 1941 në Krumë do të jetë mësues, kryemësues, edukator, drejtor i shkollës dhe i konviktit "Kosova". Në pranverën e vitit 1941 ishte ndër mësuesit e parë të kualifikuar që erdhën në Kosovë për të hapur shkolla shqipe. Së pari ishte në Plavë, ku hapi kursin e shqipes, pastaj mësues dhe kryemësues në Deçan. Më 1942 ishte drejtor i Shkollës fillore "Lidhja e Prizrenit" në Pejë, ndërsa më pas përgjegjës i arsimit, nënkryetar dhe kryetar i Këshillit Popullor të Pejës, instruktor i shkollave shqipe për Pejë, Gjakovë dhe Istog. Më 1946 ishte drejtor i Shkollës Normale Shqipe të Gjakovës, si dhe mësimdhënës për lëndët

histori, pedagogji, matematikë e muzikë. Nga viti 1953, po në Gjakovë, ushtron detyra të ndryshme në arsim: drejtor i Gjimnazit "Hajdar Dushi", themelues i Shkollës së Amvisërisë, mësimdhënës në Shkollën Ekonomike, drejtor i konviktesh të shkollave të mesme, njëri nga themeluesit e Teatrit amator "Emin Duraku" dhe të Universitetit të Punëtorëve. Nga viti 1958 është mësimdhënës i gjuhës frënge në Normalen dhe gjimnazin e Prishtinës, drejtor i Konviktit të Normales dhe këshilltar pedagogjik. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 në Tiranë. B. Kastrati ishte kryetari i parë i Shoqatës së Veteranëve të Arsimimit të Kosovës. Është autor, bashkautor dhe përkthyes i disa teksteve shkollore, të aritmetikës, gjeometrisë, algjebërës, kimisë etj. U mor edhe me poezi. Për punë të suksesshme arsimore mori shumë mirënjohje dhe dekorata të larta. (Ali Llunji)

KASTRATI Besnik (1949-1997). Inxhinier i elektroteknikës, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në Prishtinë, ndërsa studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit (1978), ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin Elektroteknik të UP-së (1985). Pas studimeve u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik për lëndën bazat e elektroteknikës. Në këtë fakultet punoi si ligjërues, docent dhe profesor inordinar për shumë lëndë të bazave teorike të elektroteknikës: elektromagnetikë, teori të qarqeve elektrike, sintezë e rrjeteve elektrike etj. Është autor, bashkautor dhe përkthyes i disa dispensave dhe teksteve universitare nga lëmi i teorisë së qarqeve elektrike, të bazave të elektroteknikës dhe të elektromagnetikës. Ishte prodekan për çështje mësimore (1981-1983) dhe dekan i Fakultetit Elektroteknik (1988-1992). Botoi punime profesionale dhe shkencore nga lëmi i përpunimit digjital të sinjaleve. (Ali Hamiti).

KASTRATI Binak (1938-). Mjek, gjinekolog, obstetër, profesor universiteti. Lindi në Dobërdol të Pejës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Pejë. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Beograd (1964). Me të përfunduar studimet u kthye në Pejë, fillimisht punoi si mjek në Lugun e Baranit. Ishte ndër



BINAK KASTRATI

mjekët e parë shqiptarë të rajonit të Pejës. U kthye të punojë në Pejë dhe bëri specializimin për gjinekologji me obstetrikë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zagrebit. Punoi në Pejë dhe u angazhua si mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1973 u punësua në repartin e gjinekologjisë (më vonë Klinika Gjinekologjike-Obstetrike e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës). Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Beogradit, u emërua asistent i lëndës së gjinekologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ku mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në vitin 1985. Më pas u zgjodh profesor inordinar i gjinekologjisë me obstetrikë. Ka qenë prodekan i Fakultetit të Mjekësisë në periudhën 1992-1997 në kushtet e vështira të organizimit të mësimi jashtë objekteve mësimore-shëndetësore. Mori pjesë në shumë kongrese dhe simpoziume brenda dhe jashtë vendit dhe publikoi një sërë punimesh profesionale dhe shkencore, si autor dhe bashkautor. (Sejdullah Hoxha)

KASTRATI Fatos (1954-2007). Xhirues filmi e televizioni. Lindi në Pejë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për kamerë i kreu në Akademinë e Filmit në Beograd. Punoi në Televizionin e Prishtinës, ku realizoi dhjetëra filma dokumentarë, filma televizivë dhe emisione dokumentare. Kryesisht u mor me realizimin e programeve të ndryshme televizive, reportazhe, emisione tematike dhe dokumentare etj. Punoi edhe në projekte më të mëdha, si në filmin televizivë "Dhimbja krenare" (1990) të I. Ymerit, ku ishte drejtor i fotografisë dhe në filmin "Kulla" (1991) të Agim Sopit. Pas luftës bëri dy filma dokumentarë "Gratë e Krushës", ndërsa xhiroi filmat "Fotografia" dhe "I zhdukuri" të J. Ahmetaj, "Nënë" e "Dimri i shpirtit" të B. Berishës etj. Një kohë jetoi e punoi në Gjermani, ku realizoi disa reportazhe e filma dokumentarë për Radiotelevizion Shqiptar. (Gani Mehmetaj)

KASTRATI Haxhi (1955-). Piktur. Lindi në Raushiq të Pejës. Kreu Fakultetin e Arteve në

Prishtinë. Punoi si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. H. Kastrati në vijimësi paraqet shqetësimet e tij në krijimtari përmes veprave me tematikë nga ambienti autokton, si “Sytë e përgjakur”, “Alpet Shqiptare”, “Në Dukagjin” etj. Për punën e tij mori disa çmime, ndër të cilët edhe çmimin e parë për pikturë në Galerinë e Armatës Popullore të Jugosllavisë në Beograd (1985), pastaj çmimin e parë për pikturë në Ekspozitën e Nëntorit në Beograd (1990), çmimin e parë për pikturë në Ekspozitën e Nëntorit në Prishtinë (1999), si dhe çmimin e Shoqatës së Rajonit të Pejës të Artistëve Figurativë (2002). (Bislim Aliu)

KASTRATI Isa (1947-1999). Veprimtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në Hogosht të Kamenicës. Punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme



ISA KASTRATI

në Kamenicë, Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë. Si pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1968 u dënua me burg. Më 1975 u arrestua sërish dhe u dënua me 6 vjet burg. Gjatë mbajtjes së burgut u dënua edhe dy herë të tjera, me nga tri vjet burg

në Spuzh të Podgoricës. Pasi vuajti dënimin me mbi 10 vjet, u lirua në korrik të vitit 1986. Ishte kryetar i Këshillit Republikan për Ndhimja Emergjente, aktivisti i Këshillit Komunal të Financimit në Prishtinë, aktivisti dhe anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kryetar i degës së tretë të LDK-së dhe kryetar i Këshillit Ndërpartiak të Degëve të Prishtinës. Pas përçarjes së LDK-së në kuvendin e tretë zgjedhor (1998), së bashku me kryesinë e Degës së Tretë të Prishtinës kaluan në Lidhjen e Bashkimit Demokratik, ku u emërua kryetar i parë i kësaj dege. Më pas u bë anëtar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), ndërsa si ushtar i UÇK-së në Zonën Operative të Llapit u emërua në detyrën me përgjegjësi në këtë zonë. Organizoi dhe udhëhoqi guerilen e UÇK-së të qytetit “BIA”. Më 21 prill 1999 u vra në fshatin Bullaj të Marecit. (Ruzhdi Jashari)

KASTRATI Kadri (1960-). Ushtarak, ish-zëvendëskomandant i Zonës Operative të Llapit, komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovë. Lindi në fshatin Katunishtë Velikorekë



KADRI KASTRATI

të komunës së Podujevës. Kreu shkollën e mesme ushtarake në Split, Kroaci (1981), ndërsa Fakultetin e Mbrojtjes e përfundoi në vitin 1987 në Sarajevë. Ishte epror ushtarak në ish-Armatën Popullore të Jugosllavisë, ndërsa me shpërthimin e luftës në Kroaci, mori pjesë aktivisht në luftën mbrojtëse të Republikës së Kroacisë. U kthye në Kosovë në fund të majit 1998 dhe u përfshi në organizimin ushtarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në Nënzonën Operative të Llapit. Në korrik të vitit 1998 u emërua në detyrën e zëvendëskomandantit të Shtabit të Zonës Operative të Llapit, detyrë që e kreu deri në demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së në shtator të vitit 1999. Më pas u emërua shef i departamentit të logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Këtë detyrë e kreu deri në vitin 2002, kur u emërua komandant i Zonës IV të TMK-së në Mitrovicë. Me themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në vitin 2009, u emërua drejtor i drejtorisë së operacioneve dhe në vitin 2011 u emërua komandant i FSK-së. U pensionua me gradën e gjenerallejtënantit. (Ismet Cakiqi)

KASTRATI Lyra (1985-). Kompozitore. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës (2003). Studioi dhe u diplomua (2008) në “Haute Ecole de Musique” në Gjenevë (Zvicër) për kompozim instrumental dhe elektroakustikë. Po aty kreu dhe masterin (2011) për teori muzike dhe kompozim (prof. X. Bouvier). Ka kompozuar vepra korale (“Jezu”, çmimi i parë, Festivali i Muzikës së Shenjtë, Prishtinë, Shkodër, 2003); për zë(ra) e piano (“Kënga e natës”), pianistike (“Daudream” I, II, III...), solistike (“Echoes of the Past” për trumbetë dhe elektronikë), kamerale (“N’at’ zaman t’asaj furie”, për soprano, flaut e piano; “Light of the Past” I, II për flaut, violonçel e piano) dhe orkestrale. U prezantua në koncerte dhe në festivalet: “Re-Musica”, “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Shopen Piano Fest” etj. Veprat e saj u ekzekutuan edhe në Zvicër. Më 2011 ishte korrepetitore për lëndën balet klasik në Shkollën e Mesme të Muzikës, më 2013 ligjëruese e lëndës format muzikore në

Fakultetin e Arteve. Më 2015 mësimdhënëse e lëndës kontrapunkt në Shkollën e Mesme të Muzikës. Është autore e disa emisioneve muzikore. (Arnisa Rexhepi)

KASTRATI Ragip (1955-). Profesor universiteti. Lindi në Turjakë, komuna e Malishevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës (UP) më 1980. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Novi-Sadit, ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së (1997). U punësua në kombinatin bujqësor industrial “Progres Export” në Prizren (1980). Ndërkohë zgjidhet asistent për lëndën të ushqyerit e kafshëve shtëpiake në Fakultetin e Bujqësisë të UP-së. Në vitet vijuese i merr të gjithë titujt universitarë. Ka botuar një numër punimesh shkencore dhe profesionale në revista që botohen në vend dhe në botën e jashtme. (Xhevat Domi)

KASTRATI Ruzhdi (1943-2003). Matematikan, profesor universiteti. Lindi në Karaçevë të Epërme (Kamenicë). Pas shkollës fillore, kreu shkollën normale në Gjilan, studioi matematikën në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Vazhdoi studimet pasuniversitare në Zagreb dhe në Prishtinë dhe specializimin në Universitetin “Lomonosov” të Moskës. Magjistroi dhe doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Fillimisht ishte mësimdhënësi i matematikës në shkollën fillore “Aca Maroviq” në Prishtinë, pastaj në Shkollën Normale të Prishtinës, ligjërues i matematikës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan, profesor në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë, më pas profesor dhe dekan i Fakultetit të Mësuësive. U mor kryesisht me matematikë dhe me trigonometri. Mori pjesë në kongrese shkencore dhe botoi punime shkencore-profesionale në revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. (Ismet Potera)

KASTRATI Sefedin (1950-) Inxhinier i xehetarisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet i mbaroi në Fakultetin e Xehetarisë të Universitetit të Sarajevës (1974). Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Xehetarisë-Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti

në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (UP) (1988). Në vitin 1987 u zgjodh ligjërues në Fakultetin e Xehetarisë të UP-së, më pas docent, profesor i asociuar dhe në vitin 2009 profesor i rregullt. Punoi në minierën e Hajvalisë (1975), pastaj ishte drejtor i minierave me flotacion Kishnicë-Novobërdë (1988). Kreu shumë detyra profesionale e shkencore në institucionet e Kosovës. Në fushën e shkencave të xehetarisë ka bashkëpunuar në shumë tema dhe projekte. Është autor i disa teksteve-doracakë për mësim për disa fusha. Ishte pjesëmarrës në disa simpoziume të vendit dhe ndërkombëtare si dhe autor tekstesh të botuar në revista shkencore. Ka ushtruar dhe funksione drejtuese në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të UP-së. (Izet Zeqiri)

KASTRATI Skënder (1947-). Veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Karaçevë të Epërme, komuna e Kamenicës. Shkollimin bazë e mori në vendlindje dhe në Gjilan, ndërsa Fakultetin Ekonomik e kreu në Prishtinë. Ishte njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968 në Kosovë. Më 27 nëntor 1968, së bashku me Osman Dumoshin, në Prishtinë lexuan dhe paraqitën kërkesat e demonstruesve. U burgos dhe u dënua me katër vjet burg. Pas daljes nga burgu i vazhdoi studimet dhe veprimtarinë ilegale antishtetërore. Në maj të vitit 1975 burgoset për herë të dytë dhe dënohet me dhjetë vjet burg. Në mars të vitit 1989, kur Serbia suprimoi autonominë e Kosovës, arrestohet dhe mbahet i izoluar për dy muaj në burgun e Leskocit e të Zajëçarit. Veprimtarinë politike e vazhdoi edhe gjatë viteve ‘90 kur i bashkëngjitet Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Në Kuvendin e parë të LDK-së, në maj të vitit 1991, u zgjodh anëtar i kryesisë së kësaj partie. Në korrik të vitit 1994 u rizgjodh sërish në forumet drejtuese të LDK-së. Në vitin 1998 u bë këshilltar dhe zëvendësi i Adem Demaçit, kur ai mori detyrën e përfaqësuesit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas përfundimit të luftës së vitit 1999 tërhiqet nga aktiviteti politik dhe punoi në kompaninë “Salbatring” deri në pensionim. (Arbër Salihu)

KASTRATI Shpejtim (1976-). Aktor. Lindi në Rahovec, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Aktrimin e mbaroi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Në Teatrin Kombëtar

të Prishtinës dhe në teatro të tjera realizoi një sërë rolesh kryesore, dytësore dhe episodike, nga të cilët më të realizuarat konsiderohen rolet kryesore në shfaqjet: “Orestia”, “Mosmarrëveshja”, “Mbreti Lir”, pastaj role dytësore dhe episodike në shfaqjet “Makbethi”, “Shfaqja e fundit”, “Fedra”, “Shtepia në ankand”, “Grafitet” dhe role tjera në shfaqjet “Pavijoni D”, “Kali i Trojës”, “Pulëbardha”, “Bodrumi”, “Komploti ilir”, “Tregtari i Venedikut” etj. Krahas punës së tij në teatër, realizoi edhe role në filmat: “I zhdukuri”, “Përtej ylberit”, “Gomarët e kufirit”, “Kodi i jetës” dhe në serialet televizive “Martesa e bariut”, “Policët” etj. (Emin Emini)

KASTRIOTËT. Familje bujare dhe princërore shqiptare, e dokumentuar për herë të parë në vitin 1368. Në mungesë të burimeve relevante zyrtare, edhe sot diskutohet për vendlindjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, përkatësisht për vendin e origjinës së familjes së tij. Sipas veprës së Barlecit kushtuar Skënderbeut, origjina e Kastriotëve duhet kërkuar në rajonin e Matit. Ndërsa historiani raguzan me origjinë arbërore, Jak Lukari në veprën “Analet e Raguzës” shkruante se familja e Gjon Kastriotit ka dalë nga “Kastrati, fshat në juridiksionin e Hasit në Arbëri, pak më larg nga lumi Drin”. Kjo dëshmi për origjinën hasiane të familjes Kastrioti provohet edhe nga Frang Bardhi në veprën e tij kushtuar Skënderbeut (1636), si edhe nga një manuskript (rreth shek. XVI) të publikuar në vitin 1892 nga studiuesi P. Eusebius Fermexhin, në të cilën thuhet: “Kastrioiqët e Kastriotit ishin nga provinca Has në Epir”. Në favor të kësaj shkon edhe njoftimi se emri i tyre i vjetër ka dalë nga fshati Mazrek i Hasit, ku përveç këtij fshati në këtë rajon zotëronin edhe fshatra të tjera, si Kostur dhe Ujmishte (Vumestje). Por janë ruajtur edhe burime të tjera që e kundërshtojnë tezën e prejardhjes hasiane të Kastriotëve.

Personaliteti i parë historik i familjes Kastrioti është Pal Kastrioti (gjysma e dytë e shek. XIV), gjyshi i Skënderbeut, i cili prej kohësh zotëronte fshatrat Sinjë dhe Gardhi i Poshtëm, si dhe më vonë dy Dibrat. Zgjerimi dhe fuqizimi i familjes Kastrioti nga selia e tyre në Krujë u realizua sidomos në kohën e Gjon Kastriotit (?-rreth vitit 1438/43), si dhe të birit të tij, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Në historinë dhe gjenealogjinë e shtëpisë së Muzakajve, të shkruar nga Gjon Muzaka (më 1512), despot

i Epirit, si dhe nga biografët e tjerë thuhet se Kastriotët i takonin elitës së familjeve më të respektuara të Arbërisë dhe të Epirit.

Biri i Palit, Gjon Kastrioti diku rreth vitit 1400 u bë zot i Krujës. Nga një marrëveshje tregtare-doganore me Republikën e Raguzës (1420) ishin përcaktuar edhe kufijtë e Kastriotëve, prej Shfadaje në jug të Lezhës deri në Prizren. Në vitin 1426, Gjoni dhe katër bijtë e tij i dhuruan dy fshatra Manastirit të Hilandarit. Gjon Kastrioti, ndërkaq, dispononte një ushtri prej 2,000 kalorësish, si dhe gëzonte të drejtën e qytetarisë venedikase (1413). Luftërat kundër osmanëve i kishte nisur që nga vitit 1388. Me gjithë përpjekjet e tij për të formuar një aleancë me Republikën e Venedikut dhe pas rënies së Krujës nën osmanët (1415), ai qe detyruar t'i dërgonte bijtë e tij peng në oborrin e sulltanit. Çështja se kur u mor peng Skënderbeu, në historiografi përgjithësisht ka disa pasaktësi: 9-vjeçar ose 18-vjeçar. Dorëzimi mund të ketë ndodhur në vitin 1415 ose 1423. Atje Gjergji u konvertua në mysliman dhe mori emrin Skënder (nga Aleksandër), si dhe u edukua në shkollën e iç-ogllanëve. Mori pjesë në fushata ushtarake kundër të krishterëve, për çarsye babai tij ishte detyruar të kërkonte falje nga Senati i Venedikut (1428). Për veprat e tij ushtarake, ai qe nderuar me titullin bej dhe me emrin Skënderbe ose Skënderbeg, emër me të cilin do të bëhet i njohur në gjithë botën. Rreth vitit 1430, Gjoni pranoi pushtetin e sulltan Muratit II. Atëherë mbi pjesën më të madhe të pronave të tij u vendos administrata osmane e quajtur “Sanxhaku Arvanid” (1431/32). Në pjesët e mbetura të tokave të veta, ku nuk mund të depërtonin osmanët, edhe pse kishte pranuar vasalitetin, Gjoni do të mbetet edhe më tej zot i tyre. Mirëpo, gjatë viteve 1432-35, kur në Arbëri kishin shpërthyer kryengritjet e mëdha, nuk flitet fare për të. Ka të ngjarë se Gjoni i kishte mbetur besnik sulltanit. Në gjendjen e palakmueshme nën osmanët, Gjoni do t'i kthehet Republikës së Venedikut e të Raguzës, duke u përpjekur të bënte kthesë politike. Nga marrëdhëniet e tij me Raguzën dhe Venedikun janë ruajtur disa burime zyrtare: një prej tyre, që mban vulën e 10 korrikut 1439 bën fjalë për shpalljen e djemve të Gjonit për “qytetarë” të Raguzës. Gjon Kastrioti u martua me Vojsavën (nuk është ruajtur asnjë njoftim për datën e vdekjes së saj), vajzë e kryezotit të Pollogut, me të cilën

pati katër djem: Reposhin (murg në Manastirin e Hilandarit, i vdekur në vitin 1431), Stanishin (i vdekur para vitit 1455), Konstandinin (më 1439 mori të drejtën e qytetarit të Raguzës) dhe Gjergjin (Skënderbeun), si dhe pesë vajza: Mara, Jella, Angelina, Vlaica dhe Mamica, motra më e vogël e Skënderbeut, e cila qe martuar me Muzak Topinë (1445). Pas vrasjes së të shoqit në Betejën e Beratit (1455), Mamica mori qeverisjen në tokat e bashkëshortit me seli në fortifikatën e Petrelës. Katër bijat e tjera u martuan të gjitha me princër: Mara u martua me Shtjefën Cernojoën e Zetës, Vlaica me Shtjefën Balshën; Angelina me Vlash Arianitin, ndërsa Jella u bë murgeshë.

Fëmijë të Skënderbeut ishin Gjoni II (1454-pas vitit 1502) dhe Vojsava. Gjoni II, pas vdekjes së Skënderbeut (1468), qytetin e Krujës ua dha venedikasve dhe së bashku me nënën Donika Kastriotin, bijë e Gjergj Arianit Komnenit (e martuar më Skënderbeun më 1451), ishin vendosur në feudet e Kastriotëve në Gargano të Mbretërisë së Napolit (1474). Gjoni II kishte tre fëmijë: Konstandinin, Ferrantën dhe Gjergji II Kastrioti, i quajtur Skënderbeu i Ri (1476-?), i cili doli në skenën historike gjatë kryengritjes së vitit 1499, që kishte rezultuar me sukses. Pasardhësit e Gjonit II Kastrioti u shuan në brezin e dytë. E fundit që i përkiste kësaj dinastie ishte princesha e Shën Pjetrit, Irena, bija e princ Ferrantit, e martuar me Pietrantonio Sanseverinon (1539), princ nga Bisignano. (Jahja Drançolli)

KASTRIOTI. Shih: OBILIQI.

KASUMI Haki (1950-). Historian. Lindi në Grabanicë të Klinës. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Prishtinë. Në vitin 1974 i përfundoi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më 1980 magjistroi, ndërsa më 1985 mbrojti temën e doktoratës. Një kohë punoi në Entin Krahinor të Statistikës, më pas në gjimnazin e Lipjanit dhe në Shkollën e Mesme Ekonomike në Prishtinë. Në nëntor të vitit 1975 u punësua në Institutin e Historisë. Në vitet '80 të shekullit të kaluar, si bashkautor, hartoi dhe botoi disa tekste shkollore, ndërsa në revista shkencore botoi kontribute të ndryshme nga historia dhe mori pjesë me kumtesa në konferenca shkencor brenda e jashtë Kosovës. Ka botuar monografitë: "Bashkësitë fetare në Kosovë"

(1988), "Segmente të gërshtuara të historisë" (2011), "Këshilli koordinues i asociacioneve familjare të të zhdukurve të Kosovës" (2013), "Sadik Zeneli (1888-1945)" (2015), si dhe është bashkautor i "Historisë së popullit shqiptar", pjesa III (2002). (Sulltane Ukaj)

KASUMI Ismail (1949-). Punëtor sportiv, zhytës. Lindi në Grabanicë të Klinës. Kreu shkollën e mesme ekonomike në Prishtinë dhe Fakultetin e Kulturës Fizike. Punoi një kohë të gjatë si referent për çështje të studentëve në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Ishte drejtor i Drejtoratit për Sport në KK të Prishtinës gjatë viteve 2001-2004, ndërsa në periudhën 2001-2008 ishte drejtor i departamentit të sportit të Kosovës në Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit. Që nga viti 2008 deri në vitin 2013 punoi si drejtor i Shtëpisë së Sporteve në Prishtinë. Me sportin e zhytjes Kasumi ka filluar të merret që nga viti 1970, në KZH "Prishtina". Është zhytësi i parë kosovar. Në karrierën e gjatë prej zhytësi Kasumi ka nxjerrë nga uji 547 viktima, ndërsa është mbi një mijë numri i njerëzve të shpëtuar prej tij. (Bekim Aliu)

KATEDRALJA E ZOJËS NDIHMËTARE, PRIZREN (1870). Objekt kulti që gjendet në pjesën urbane të qytetit të Prizrenit, në Qafëpazar. Ky objekt monumental i komunitetit katolik shqiptar u ngrit mbi themelet e një kisha të periudhës paleokristiane nga shek. IV-VI. Katedralja edhe sot është aktive. Në shekullin XX kishës iu shtua edhe kambanorja. Në kuadër të katedrales, ndërkohë, janë ngritur edhe disa objekte të tjera përcjellëse për nevojat e personelit fetar. Kisha i takon tipit bazilikë me tri anijata. Anijata kryesore, për dallim nga ato anësore, është më e lartë dhe përfundon me absidë gjysmërrethore, e cila mbulohet me kalotë. Në brendësinë e absidës është altari me dy kthina të veçanta, që shërbejnë për liturgji. Çatia e anijatës kryesore është dyujëse, ndërsa ato të anijatave anësore janë njëujëse. Çatia mbulohet me qeramidhe tradicionale. Kisha u ndërtua me gurë paksa të përpunuar dhe të lidhur me llaç gëlqereje. I takon stilit neoklasik, përkatësisht neoromanik. Objekti ndriçohet dhe ajroset me dritare të mbuluara me hark dhe rozetë. Në enterierin e kishës, pos pikturave murale me tematikë biblike nga Dhiata e Re, paraqiten edhe dy portrete historike, ai i

Skënderbeut dhe i Huniadit, të realizuara në dekadën e tetë të shek. XIX. Në kompleksin e katedrales ishte edhe shkolla shqipe dhe ajo e vashave, e hapur në fund të shek. XIX. Kompleksi si tërësi ruan gjendjen fillestare dhe ka vlerë historike, arkitekturale, fetare, arsimore dhe kulturore. (Fejz Drançolli)

KATIÇIQ Radoslav (Radoslav Katičić) (1930-). Filolog klasik, sllavist, indoeuropianist. Profesor i gjuhësisë së përgjithshme dhe krahasuese i Universitetit të Zagrebit, ndërsa



RADOSLLAV
KATIÇIQ

nga 1977 profesor i filologjisë sllave në Universitetin e Vjenës. Është anëtar i Akademisë së Shkencave të Kroacisë, të Austrisë, Bosnjë e Hercegovinës, Norvegjisë, Kosovës dhe Akademisë Europiane të Shkencave. “Doctor Honoris Causa”

i Universitetit të Budapestit. Në Kroaci solli idetë e gjuhësisë teorike moderne. U mor me studimin e gjuhëve të Ballkanit të lashtë, me letërsinë bizantine. Botoi shumë studime nga sllavistika. Studiuesi më i njohur i onomastikës ilire. Në veprën e rëndësishme “Gjuhët e lashta të Ballkanit” (The Ancient Languages of the Balkans, 1976) u mor edhe me prejardhjen e shqipes. Mendon se shqipja rrjedh nga ilirishtja. Në vitin 1973 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë Jugosllave (më vonë Kroate) të Shkencave dhe të Arteve, kurse në vitin 1987 u bë edhe anëtar i saj i rregullt. Botoi libra shkencorë në gjuhën kroate, gjermane dhe angleze. (Naile Mala-Imami)

KATIÇIQ (Katić) Tatjana (1967-). Historiane, osmanologe serbe nga Beogradi. Studioi për histori në Fakultetin Filozofik në Beograd. Në vitet 1992-1993 ishte për specializim profesional në Turqi. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi turke në Fakultetin e Filologjisë në Beograd më 1995. Mbaroi studimet e magjistraturës në Universitetin e Beogradit, ndërkaq tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Universitetin e Sarajevës në vitin 1994. Punon në Institutin e Historisë në Beograd nga viti 1994. Është autore e dhjetëra artikujve shkencorë nga fusha e osmanistikës, turkologjisë dhe historisë. Në vitin 2010 publikoi defterin e hollësishëm të sanxhakut

të Prizrenit të vitit 1571, ndërkaq në vitin 2012 botoi monografinë mbi rivendosjen e administrimit osman në Ballkan pas luftërave austro-osmane 1683-1690 (“Pushtimi turk i Serbisë në vitin 1690”). Në këtë monografi jepen përshkrime të hollësishme edhe për Kosovën, mbështetur në kronikat osmane të kohës. (Gazmend Rizaj)

KATUN. Vendbanime mesjetare me banorë të organizuar, që merreshin kryesisht me blegtori. Bëhet fjalë për një ballkanizëm, ndoshta sipas rumanishtes: çätun: fshat i vogël < katund. Me këtë emërtim nganjëherë quhej fshati baritor në disa pjesë të Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Kroaci), që zakonisht ishin vendosur në kullota malore. Në krye të katunit ishte një prijës i fshatit, i cili kishte kompetenca administrative dhe gjyqësore. Shumë vende në Histri, ku ishin ngulitur ardhacakët nga Shqipëria e Sipërme nga fundi i mesjetës dhe gjatë shek. XVI-XVIII u quajtën katun ose katune. Në fillim kishte kuptimin e një bashkësie shoqërore që funksiononte në bazë të lidhjeve të afërta të gjakut. Më vonë ky emërtim u bë sinonim vetëm për vendbanimet me bazë ekonomike blegtorale. Banorët e katuneve shtegtonin me bagëtitë e tyre në kullosa sipas stinëve. Procesi i shndërrimit të katunit në fshat në zonat e Shqipërisë Veriore dhe Verilindore duhet të ketë përfunduar nga fundi i shek. XVI. Në viset e zonave fushore në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë Perëndimore ekzistonin fshatra bujqësore ose bujqësore-blegtorale shumë kohë para pushtimit osman. (Muhamet Mala)

KAVAJA Burhan (1943-). Inxhinier i xehetarisë, aktivist sindikal. Lindi në Mitrovicë. Studimet i kreu në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradi.



BURHAN KAVAJA

Punoi si mbikëqyrës dhe udhëheqës teknik në minierat e Kishnicës dhe të Novobërdës. Më pas, si inspektor krahinor i xehetarisë, themeloi inspektoratin e inspeksioneve teknike të Kosovës, ku ishte edhe kryeinspektor. Më pas punoi në Sekretariatën Krahinor për Ekonomi dhe ishte sekretar për industri në Odën

Ekonomike të Kosovës, drejtor i përgjithshëm i kombinatit “Sharr” në Han të Elezit dhe drejtor i përgjithshëm i minierës me flotacion “Trepça” në Stantërg. Ishte ligjërues në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës nga themelimi. Mori pjesë në shumë projekte profesionale në përgatitjet e legjislacionit për xehetari dhe energjetikë, pjesëmarrës në shumë kongrese rreth teknikave të sigurisë etj. Ishte i angazhuar në projekte për modernizimin e “Trepçës”. Në fund të viteve ’80 u përfshi në ngjarjet politike rreth “Trepçës” dhe më vonë, gjatë viteve ’90, në lëvizjen sindikale në Kosovë. (Izet Zeqiri)

KAZAZI Abaz (1929-). Ekonomist. Lindi në Gjakovë. Shkollën e mesme ekonomike e kreu në Beograd (1955), Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Zagrebit (1971), ku më pas edhe magjistroi. Gjatë viteve 1948-1953 ishte kryetar i Bashkimit të Kooperativave të Gjakovës, nga ku fillon edhe kontributi i tij në zhvillimin e bujqësisë së Kosovës. Mori përsipër të gjitha detyrat dhe vështirësitë e zbatimit të reformave agrare të asaj kohe, si dhe të risive në proceset e prodhimit të bujqësore. Më pas ishte drejtor i Minierës së Kromit në Devë të Gjakovës, drejtor i Ndërmarrjes së Tekstilit “Emin Duraku” po në Gjakovë, sekretar i Odës Ekonomike të Kosovës, ku ka dhënë kontribut të madh në zhvillimin e bujqësisë. Ka qenë sekretar i Financave të Kosovës dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, ndërsa vazhdon angazhimi i tij në zhvillimin e bujqësisë përmes krijimit të politikave të favorshme agrare dhe të mbështetjes së investimeve në bujqësi. Gjatë viteve 1971-1981 ishte Guvernator i parë i Bankës Popullore të Kosovës, e cila atëbotë kishte rolin e bankës qendrore. (Florentina Xhelili)

KAZAZI Esat (1946-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë. Kreu studimet në Fakultetin e Makinerisë dhe të Anijendërtimitarisë të Universitetit të Zagrebit (1970). Pas studimeve u punësua në Gjakovë, në fabrikën “Napredak”, më pas në fabrikën “Metaliku” si kryeinxhinier, drejtor teknik dhe zëvendës drejtor i përgjithshëm për 20 vjet me radhë. Kontribut të çmuar ka dhënë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të industrisë metalike brenda kompleksit industrial “Tre-

pça”. Ishte ndër nismëtarët e hapjes së Shkollës së Mesme Teknike në Gjakovë. Më pas punoi në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit të Prishtinës, si asistent i lëndës rezistenca e materialeve. Punoi në shumë projekte infrastrukturore dhe zhvillimore të ekonomisë së Kosovës në fushën e makinerisë. (Xhevhat Perjuci)

KAZAZI Gjon Nikollë (1702-1752). Kryepeshkëv i Shkupit, lëvrues i gjuhës shqipe, përkthyes tekstesh fetare. Lindi në Gjakovë. Ka studiuar në kolegjet e Feros dhe të Loretos, ku është laureuar doktor në filozofi e teologji. Ka zhvilluar veprimtari klerikale në vendlindje e në Prizren si shekullar dhe misionar apostolik. Ka qenë vikar i përgjithshëm i dioqezës së Shkupit. Ka qenë njohës i rrethanave në Ballkan. Më 1742 ka kryer një vizitë apostolike në Argjipeshkvinë e Bullgarisë. Ka pasur raporte bashkëpunimi me Visk Zmajeviqin dhe me të tjerë në Zarë e në Itali. Më 1743 është emëruar argjipeshkëv i dioqezës së Shkupit dhe administrator për gjithë Mbretërinë e Serbisë. Më 1743 e ka zbuluar në Romë “Mesharin” e Buzukut. Më 1743 në Romë ka botuar “Përmbledhje e shkurtër e Doktrinës së kërshterë, përkthyer në gjuhën shqipe për përdorim dhe mësim për fëmijët e këtij kombi” (Breve compendio della Dottrina Cristiana, tradotta in lingua albanese per l'utilità e l'istruzione dei fanciulli di quella nazione). Vepra është e natyrës doktrinale. Është shkruar në të folmen geqe verilindore të Gjakovës me alfabetin që përdorej tek autorët gegë para tij me pak ndryshime. E rëndësishme për njohjen e së folmes së Gjakovës. Teksti dhe gjuha e këtij botimi kanë qenë objekt studimesh të veçanta nga K. Ashta dhe H. Agani. B. Demiraj e ka bërë botimin kritik me faksimile dhe konkordanca e studim të tekstit më 2006. (Rexhep Ismajli)

KAZAZI Shefqet (1933-). Mësimdhënës i muzikës, kompozitor. Lindi në Gjakovë. Pas kryerjes së shkollës fillore në vendlindje dhe Shkollës së Mesme të Muzikës në Prizren (1953), u diplomua në drejtimin teorik-pedagogjik në Fakultetin e Muzikës në Beograd. I përket brezit të parë të shqiptarëve të Kosovës me diplomë të Akademisë së Muzikës. Pas kryerjes së studimeve ishte pedagog muzikor në Normalen e Gjakovës, më pas edhe në Akademinë Pedagogjike. Është

autor i doracakut “Edukata muzikore” për kl. V e VI të shkollës fillore. Gjatë veprimtarisë prej pedagogu, ka përpunuar e kompozuar kompozime e këngë korale për të rinj e pionierë. (Zeqirja Ballata)

KEÇMEZI-BASHA Sabile (1945-). Lindi në Koretin të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Kamenicë. Më 1977 kreu Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në degën e historisë, ku edhe doktoroi më 1984. Nga viti 1978 punon në Institutin e Historisë së Kosovës. Botoi punime e vepra të ndryshme nga historia: “Zhvillimi historik i PKJ-LKJ-së në Kosovë më 1945-1966”, (1987), “Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë më 1945 – 1948” (1998), “Programet politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878-1990” (2013), si dhe vepra letrare: “Nata pa kornizë” (roman, 2008), “Nusja e gurtë” (poezi, 1989) etj. Me punimet shkencore mori pjesë në tubime shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Në periudhën 2001-2004 ishte deputete e Parlamentit të Kosovës. (Izber Hoti)

KEFALIU. Përfaqësuesi më i lartë i qeverisjes lokale në qytetet mesjetare. Emërohej nga sundimtari dhe ishte i deleguar ose nëpunës i pushtetit të tij. Institucioni i kefaliut fillimisht ishte në fuqi në Bizant. Si nëpunës perandorak, kefalinj të ndaheshin në të përgjithshëm dhe lokalë. Të parët qeverisnin një krahinë të gjerë, të përbërë nga disa njësi themelore qeverisëse, ndërsa të dytët një ose dy qytete me rrethina. Institucionin e kefaliut nga Bizanti e ndeshim në qytete bregdetare të Shqipërisë dhe më vonë edhe në qytete mesjetare të Kosovës. Në vise të pushtuara nga shtetit i Rashës, kefalinj të ruajtën të gjithë kompetencat që i kishin në kohën e perandorëve bizantinë. Gjatë sundimit të Milutinit pati kefalinj të përgjithshëm në krahinën e Shkupit dhe të Zetës, ndërsa në kohën e Stefan Dushanit (1331-1355) u organizua institucioni i kefalinjve lokalë. Pas shpërbërjes së shtetit të Rashës (1355), institucioni i kefaliut u ruajt nga princa të ndryshëm. Në kohën e Aleksandrit, “sundimtar i Kaninës dhe i Vlorës”, përmendet kefaliu i Vlorës, Branilo dhe kefaliu i Kaninës, Kastrioti (1368). Te Černojeviqët në Zetë, të cilët nuk zotëronin qytete, është ruajtur institucioni i

kefaliut në katune dhe i bashkësive luftarake deri në pushtimin osman në fund të shek. XV. (Qerim Dalipi)


KELMENDI Adem (1930-). Mësues veteran. Lindi në Balincë, komuna e Malishevës, shkollën fillore e kreu në Carrallukë, arsimin e mesëm e vazhdoi në shkollën normale “Zef Lush Marku” në Shkup dhe diplomoi në gjimnazin e Tetovës. Studioi dhe diplomoi për mësim klasor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Gjatë karrierës si mësues punoi në Astrazub, Arllat, Negroc, Carrallukë, Zhelinë të Tetovës, Sellarcë dhe në Palqishtë të Ulët, komuna Zherovjanë. Krahas punës mësimore, u angazhua edhe në fushatën kundër analfabetizmit dhe mori pjesë në jetën kulturore e shoqërore në mjedisë ku punoi. Është bartës i shumë dekoratave dhe i mirënjohjeve. (Islam Krasniqi)

KELMENDI Adriatik (1978-). Gazetar. Lindi në Prishtinë. Mbaroi studime dhe specializime në fushën e medias dhe komunikimit. Karrierën prej gazetari e nisi në gazetën “Koha ditore”, për të kaluar më pas në Televizionin “Kohavision” (KTV). Është autor dhe udhëheqës i emisionit “Rubikon” në KTV dhe autor komentesh në gazetën “Koha ditore”. Ka raportuar për ngjarje të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare dhe ka qenë autor intervistash të shumta me liderë politikë vendore e ndërkombëtare, veçmas gjatë procesit të përcaktimit të statusit të Kosovës. Është laureat i disa çmimeve prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare. A. Kelmendi mban titullin magjistër i medias dhe komunikimit nga Goldsmiths University i Londrës. Është autori i librave publicistikë “Kapërcimi i rubikonit drejt pavarësisë” (2013) dhe “Rrëfime të përpjekjes” (2015). (Rrahman Paçarizi)



ADRIATIK
KELMENDI

KELMENDI Ahmet (1929-2016). Gjuhëtar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e mbaroi në Gjakovë. Studimet i kreu në Beograd, ndërsa ato pasuniversitare në Zagreb. Ligjëroi në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës nga viti 1964 deri



AHMET KELMENDI

më 1994, pastaj në Fakultetin e Arteve dhe të Mësuesisë. Pas luftës së fundit u angazhua në QSUU (Qendrën e Studimeve Universitare Ushtarake të Trupave Mbrojtëse të Kosovës) në rolin e këshilltarit për kulturë të gjuhës shqipe me gradën major. Ishte pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit më 1972. Është autor i katër gramatikave për ciklin fillor dhe të mesëm, dy prej tyre me bashkëpunëtorë. Përgatiti për botim veprat e Eqrem Çabejt “Studime gjuhësore I-IV”, më 1976. Shkroi një numër artikujsh, kryesisht nga fusha e drejtshkrimit në gazetat “Rilindja”, “Zani i rinisë”, “Përparimi”, “Flaka e vëllazërimit”. (Bahri Koskoviku)

KELMENDI Ali (1900-1939). Ishte ndër të parët që përkrahu dhe përhapi idetë komuniste në mesin e shqiptarëve. Lindi në Pejë, ku kreu një kurs për mësues dhe, me përkrahjen e



ALI KELMENDI

Bajram Currit, studioi dy vjet në Vjenë të Austrisë për pedagogji e psikologji. Më 1920 shkoi në Shqipëri, ku u bë një nga veprimtarët kryesorë të shoqërisë “Bashkimi”. Ishte pjesëmarrës i Revolucionit Demokratik të Qershorit të vitit 1924. Pas gjashtë muajsh emigroi në Itali, më pas në Austri e mandej në Bashkimin Sovjetik. Më 1925-1930, gjatë qëndrimit në Bashkimin Sovjetik, kreu shkollën për oficer kufiri në Leningrad. Shërbeu në Odesa si oficer kufiri. Më 1929 u bë anëtar i grupit komunist shqiptar në Moskë. Më 1930 dërgohet në Shqipëri për organizimin e lëvizjes komuniste. Mbajti lidhje me Kominternin, kështu që më 1937 u zgjodh anëtar i saj. Ndihmoi formimin e grupit komunist të Korçës dhe të celulave në Tiranë, Krujë, Vlorë, Korçë etj. Ishte njëri nga organizatorët dhe pjesëmarrësit e vullnetarëve antifashistë shqiptarë në Luftën e Spanjës (1936-1939). Bashkë me veprimtarë të tjerë përgatiti platformën e lëvizjes komuniste për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë nga fashistët dhe vendosjen e rendit demokratik. Vdiq në Paris. (Adem Murati).

KELMENDI Bajram (1937-1999). Avokat, aktivist i të drejtave të njeriut. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërkaq po atë vit (1966) u dënua me një vit burg, meqë



BAJRAM KELMENDI

kishte kritikuar shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Më pas studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Kreu detyra të ndryshme në institucionet gjyqësore të Kosovës në periudhën e autonomisë. Ishte njëri nga themeluesit e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në vitin 1989. Si avokat u angazhua në mbrojtje të të akuzuarve shqiptarë në gjyqe politike, veçmas gjatë viteve ‘90. Mblodhi fakte dhe dëshmi për Gjykatën Ndërkombëtare për Krime të Luftës në Hagë, ku më 3 maj 1998 ngriti padi kundër Sllobodan Millosheviqit për krimet e kryera në Kosovë. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s në Kosovë, më 24 mars 1999 policia serbe hyri dhunshëm në shtëpinë e tij dhe e arrestoi bashkë me dy djemtë e tij, Kastriotin dhe Kushtrimin, trupat e pajetë e të cilëve u gjetën më pas në afërsi të Prishtinës. (Mrika Limani)

KELMENDI Binak (1950-). Prozator, gazetar, përkthyes. Lindi në Llabjan të Pejës, ku kreu shkollimin fillor. Mbaroi shkollën e mesme në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi frënge në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Që nga viti 1976 filloi punën si gazetar i “Rilindjes”, në rubrikën e politikës së jashtme, më pas redaktor përgjegjës dhe kryeredaktor në gazetat “Rilindja” dhe “Bujku”, si dhe redaktor i lajmeve ndërkombëtare në të përditshmen “Zëri” dhe në portalin “Koha.net”. Shkruan tregime dhe romane. Veprat e botuara: “Rozafa” (1990), “Vezët e vdekjes” (2001), “Ofelia e Dukagjinit” (2004), “Guri i vashës” (2012). B. Kelmendi është marrë me përkthime nga gjuha frënge. Ka përkthyer romanin “Dashnori” të Margerit Dyras-së, “Anjesa dhe doktor Simoni” dhe “Anjesa dhe shtatë pikturat” të Neriman Kamberit, “Mirëdita pikëllim” të Fransuaz Sagan, “Ilirja” të Flora Dozanit, “Hajni dhe qentë” i Nagib Mahfuzit etj. Po ashtu ka përkthyer serinë e ilustrimeve për fëmijë të autorëve Gilbert Delahaye dhe Marcel Marlier. (Munish Hyseni)

KELMENDI Florin (1957-). Gazetar. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Kreu studimet për ekonomi dhe letërsi në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1979 punoi gazetar, drejtues programesh dhe redaktor në Radio Prishtinë, deri në mbylljen nga Serbia, më 1990. Ishte autor dhe drejtues i disa programeve dokumentare dhe kulturore-artistike në TV Prishtina. Në fillim të viteve '90 punoi korrespondent nga Prishtina për TV "Viktoria" në Nju -Jork dhe më pas ishte bashkëthemelues i Radiotelevizionit-21 (RTV-21) dhe i Televizionit-21 në Maqedoni, ndërsa mban pozitën e drejtorit të programeve kulturore-artistike, dokumentare dhe të aktualitetit në këtë shtëpi mediale. Në vitet 1998/99 ishte kryeredaktor dhe drejtor i Radios-21, radio e parë shqiptare në internet. Po në këto vite, në bashkëpunim me "Internews" nga SHBA-ja, ishte autor dhe producent i disa dokumentarëve dhe filmave të shkurtër për Kosovën. Ndërkohë, në RTV-21 realizoi serinë e programeve "Në orët e vona" dhe kabarenë satirike "Kabare Prishtina". (Ibrahim Berisha)

KELMENDI Ibrahim (1954-). Veprimtar i lëvizjes për çlirimin e Kosovës. Lindi në Llabjan të komunës së Pejës. Pasi kreu shkollën e mesme ndoqi studimet për fizikë në Universitetin e Prishtinës. U arratis nga Kosova në korrik të vitit 1976. Në vitin 1978 themeloi në Bohum bashkë me disa aktivistë të tjerë organizatën "Fronti i kuq popullor", ndërsa më 17 janar 1982, me Jusuf Gërvallën e Kadri Zekën, bashkëthemeloi Lëvizjen për Republikën e Kosovës. Gjatë viteve vijuese ishte aktiv në organizimet e ndryshme të emigracionit kosovar në shtetet perëndimore, veçmas në Gjermani, kryesisht në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Ishte anëtar i kryesisë së LPK-së dhe gjatë viteve '90 u angazhua për organizimin e ndihmave për luftën e armatosur në Kosovë, si anëtar i kryesisë dhe përgjegjës për Gjermani i Fondit "Vendlindja thërret". Veprimtarinë e organizuar politike e përmbylli në qershor të vitit 1999, në kuvendin e fundit të LPK-së. Që atëherë merret aktivisht me publicistikë dhe krijimtari letrare. Ka botuar shkrime të shumta publicistike, veçmas në gazetën "Zëri i Kosovës" dhe në gazetën e tjera të emigracionit kosovar. Është autor i disa librave publicistike dhe letrarë: "Shqipëria jashtë 'veriu' dhe 'jugut'" (libër për ngjarjet në Shqipëri në vitin

1997), "Atentatet" (roman historik), "Trilleri i O.J. Schmitt për Kosovën" etj. (Blerim Muriqi)

KELMENDI Ibrahim (Sylejman) (1916-1979). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste. Lindi në Preshevë. Kreu Medresenë e Madhe në Shkup. Studimet për histori i nisi në Shkup, i vazhdoi në Beograd, pastaj në Peruxha të Italisë dhe i përfundoi në Zagreb më 1942. U emërua mësimdhënës në gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë, ndërkohë ushtroi edhe detyrën e rektorit të konviktit po në këtë shkollë (1942). U mor me hulumtime shkencore në fushën e historisë. Në vitin 1944 u zgjodh kryetar i Rinisë së Ballit Kombëtar të Kosovës dhe u përfshi në organin drejtues të Komitetit Demokratik Shqiptar. Iu bashkua qëndresës shqiptare, forcave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit në frontin Kumanovë-Vrajë (1944). Ishte anëtar i Shtabit të Zonës IV të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës. Mobilizoi shumë vullnetarë në luftë kundër depërtimit të forcave komuniste në trojet verilindore shqiptare. Mori pjesë në betejat kundër forcave partizane në Preshevë, Ferizaj, Drenicë etj. Në vitin 1945 emigroi jashtë vendit. Vdiq në Melburn të Australisë. (Ilir Zylfiu).

KELMENDI Jeton (1978). Poet, dramaturg dhe publicist. Lindi më 1978 në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për komunikim masiv në Prishtinë dhe Bruksel. Shkroi dhe botoi poezi, prozë, ese dhe tregime. U mor edhe me publicistikë. Është bashkëpunëtor i shumë medieve, shqiptare dhe të huaja, ku trajton çështjet të ndryshme kulturore dhe politike. Më 1999 botoi përmbledhjen e poezive "Shekulli i premtimeve", ndërsa më pas botoi: "Përtej Heshtjes" (2002), "Në qoftë mesditë" (2004), "Më fal pak Atdhe" (2005), "Ku shkojnë ardhjet" (2007), "Erdhe për gjurmë të erës" (2008), "Koha kur të ketë kohë" (2009), "Rrugëtimi i mendimeve" (2010), "Thërras gjërat e harruara" (2013). Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja dhe janë përfshirë në disa antologji. Është anëtar i disa klubeve ndërkombëtare të poetëve dhe bashkëpunon me revista letrare dhe kulturore. Ka të botuara edhe dramat "Zonja fjalë" (2007), "Lojë dhe kundërlojë" (2011). Jeton në Bruksel. (Nazmi Rrahmani)

KELMENDI Jusuf (1927-2002). Dramaturg, gazetar, politikan. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, studimet për shkenca politike i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Njihet si autor i dramave: “Hakmarrja” (1957), “Rrëmuja” (1961) dhe “Mjalti i hidhur” (komedi satirike), të cilat janë vendosur në skenë nga trupat amatore dhe profesioniste e teatrove të Kosovës. Në vitin 1973 dramat u botuan në një vëllim të përbashkët “Tri drama”. Më 1986 botoi komedinë “Fakiri i madh”. Njihet edhe si autor i poezive dhe i tregimeve humoristike, të cilat i botoi në revistën letrare “Jeta e re”. Punoi si gazetar e, më pas edhe si kryeredaktor i gazetës “Rilindja”. Ka qenë në funksione të ndryshme politike e shoqërore në institucionet e kohës. Shërbeu gjithashtu edhe si diplomat, përkatësisht ambasador i Jugosllavisë në Senegal, Gambi dhe Mauritani. (Naime Beqiraj)

KELMENDI Majlinda (1966-). Piktore. Lindi në Tiranë. Mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. Kreu studimet për pikturë në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë dhe në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Është e njohur si krijuese e ekspresionizmit dhe e figuracionit lirik kompozicional. Kultivon lirizmin e pastër, të një emocioni e frymëzimi poetik. Hapi disa ekspozita personale në Tiranë (1997, 2012), në Bari të Italisë (2003), në Prishtinë (2005, 2011), në Lodi të Italisë (2008), në Shkodër, Shkup etj., si dhe mori pjesë në shumë ekspozita të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, si: në Gjermani, Itali, Poloni, Portugali, Belgjikë, SHBA, Bullgari, Francë, Çeki, Turqi etj. Fitoi disa çmime në manifestime artistike dhe është themeluese e institucionit të pavarur artistik “Expo 40”, ideatore dhe udhëheqëse artistike e disa projekteve multimediale. Është mësimdhënëse në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Hajrush Fazliu)

KELMENDI Majlinda (1991-). Xhudiste. Lindi në Pejë. Vlerësohet sportistja më e mirë e Kosovës e të gjitha kohëve. Nisi me xhudon në moshë shumë të re. Në vitin 2009 doli kampione e Europës dhe e Botës në xhudo për të rejtat. Një kohë nuk iu lejua të garonte për Kosovën, kështu që u paraqit për Shqipërinë. Me Shqipërinë u paraqit edhe në Lojërat Olimpikë “Londra 2012” ku u ndal në luftën e



MAJLINDA
KELMENDI

dytë. Në vitin 2013 doli e treta në Europë, pastaj fitoi medaljen e parë në gara të mëdha. Në po të njëjtin vit bëri histori, duke fituar medalje të artë në Kampionatin Botëror të mbajtur në Rio de Zhaneiro të Brazilit. Në vitin 2014 u shpall kampione e botës dhe e Europës, ndërsa nuk pësoi asnjë humbje. Po ashtu, në vitin 2014 u vlerësua më e mira në botë prej xhudisteve të të gjitha kategorive. Sukseset në gara i arriti në kategorinë deri në 52 kg. Xhudistja më e mirë e Europës është shpallur për vitet 2013 e 2014. Për shkak të një lëndimi nuk u paraqit në edicionin e parë të Lojërave Europiane të vitit 2015 në Baku, por barti flamurin e Kosovës në ceremoninë e hapjes dhe të mbylljes. Duke e përfaqësuar Kosovën, fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpikë Verore “Rio 2016” në Brazil, në kategorinë deri në 52 kg. Federata Ndërkombëtare e Xhudos e shpalli xhudisten më të mirë në botë për vitin 2016 në kategorinë e saj. (Tahir Sopi)

KELMENDI Migjen (1959-). Gazetar, shkrimtar, kantautor. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm dhe studimet për drejtësi. Ndoqi një kurs për administrimin e medias në Universitetin Concordia të Montrealit (Kanada). Me gazetari nisi të merret nga viti 1988. Më parë ishte i njohur si kantautor i grupit të muzikës rok “Gjurmët” (1980-1986). Punoi në Radiotelevizionin e Prishtinës (RTP), ku ishte autor emisionesh dhe redaktor i programeve kontaktuese. Disa muaj ishte producent ekzekutiv i televizionit shqiptaro-amerikan “Victoria” në Nju-Jork, kurse gjatë viteve 1997-1999 producent ekzekutiv i programit satelitor, edicionit për Kosovën, në Televizionin Shqiptar në Tiranë. Gjatë viteve 2000-2001 ishte drejtor i Televizionit të Kosovës. Është themelues dhe kryeredaktor i revistës “Epoka” (1991) dhe themelues dhe redaktor i revistës “MM” (1996). Nga viti 2001 ishte botues dhe kryeredaktor i gazetës “Java”. Është autor i veprave publicistike “Amerika pëj shpije” dhe “Carere Patria - Mungesa e Atdheut”. Është pronar dhe drejton TV “Rrokum” në Prishtinë. Shkroi reportazhe, ese, komente, analiza, intervista, polemika. Është autor i romanit “Gryka e kohës”. (Zenun Çelaj)

KELMENDI Naim (1959-). Shkrimtar, publicist. Lindi në fshatin Ruhot të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Shkruan poezi, prozë dhe publicistikë. Ka të botuar veprat: “Shtreza në fjalë” (1985), “Nyja e Gordit” (1992), “Albanoi” (1992), “Pse ashtu Pandorë” (1993), “Çka të bëj me dhembjen” (1993), “Satanai me fytyrë tjetër” (1994), “Eklipsi i diellit” (1997), “Përbalje me vdekjen” (1999), “Shqiptari vdes duke kënduar” (2000), “Kohë për të folur gurët” (2001), “Sipërfaqja e padukshme” (2003). Botoi edhe disa vepra me shkrime publicistike: “Beteja e Koshares” (2008), “Pikëpamje dhe reagime” (2008), “Në një jetë pas Krishtit” (2010), “Esenca” (2010), “Kronika e një vrasjeje të paralajmëruar” (2014), “Një gjurmë intelektuale përgjatë një jete” (2014) etj. Poezitë e tij janë përkthyer edhe në gjuhë të huaja dhe janë përfshirë në antologji të ndryshme. Një kohë ka jetuar në Zvicër. Ishte themelues dhe kryetar i klubit letrar “Faik Konica” në Zvicër, kryeredaktor i gazetës “Pavarësia” dhe botues i gazetës “Pavarësia News”. Ishte reporter lufte i gazetës “Bota sot” në luftën e Koshares më 1999. Drejton Shtëpinë Botuese “Rugova Art” në Prishtinë. (Nazmi Rrahmani)

KELMENDI Nekibe (1944-2011). Politikane, avokate, aktiviste për të drejtat e njeriut. Lindi në Pejë. Mësimet fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Juridik e



NEKIBE KELMENDI

mbaroi në Universitetin e Prishtinës (1968). Në periudhën 1968-1987 punoi si gjyqtare dhe më pas avokate. Ishte avokatja e parë shqiptare në Kosovë. Gjatë të së njëjtës periudhë ishte dhe sekretare e Odës së Avokatëve të Kosovës. Me fillimin e fushatës për rrënimin e autonomisë së Kosovës u shkarkua nga detyra e gjyqtares dhe deri më 1991 punoi si sekretare e përgjithshme e Barnatoreve të Kosovës, ndërkaq nga vitit 1991 iu kthye sërish punës së avokates. Më 1989 u zgjodh në kryesinë e parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe ishte njëra nga themelueset e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë. Ishte kryetare e Forumit të Gruas

së LDK-së dhe sekretare e përgjithshme e LDK-së gjatë viteve 1998-2002. Nga viti 2000 deri më 2001 ishte bashkëdrejtuese e departamentit të drejtësisë së UNMIK-ut, ndërkaq nga viti 2008 deri më 2010 ishte ministre e Drejtësisë në Qeverisnë e Republikës së Kosovës. Më pas iu kthye sërish profesionit të avokates. Shkroi punime të natyrës profesionale nga fusha juridike dhe e të drejtave të njeriut. (Mrika Limani)

KELMENDI Nexhat (1937-2014). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Mitrovicë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesmen. Studimet e xehetarisë i mbaroi në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit (1976). Pas diplomimit punoi në minierën e “Trepçës” të Stantërgut, fillimisht si drejtor i investimeve, ndërsa më vonë u zgjodh drejtor i minierës së “Trepçës” në Stantërg (1983). (Izet Zeqiri)

KELMENDI Nexhmedin (1939-). Gazetar. Lindi në Istog. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Pejë, kurse studimet për ekonomi në Beograd. Filloi punë në gazetën “Rilindja” në vitin 1968. Punoi si gazetar-reporter dhe redaktor kryesisht në sektorin e ekonomisë. Shkroi tekste të shumta autoriale nga problematika ekonomike, prodhimtaria industriale dhe politikat financiare. Punoi në “Rilindje” deri në mbylljen e saj më 1990. (Nehat Islami)

KELMENDI Qazim (1935-2004). Gazetar. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, kurse Fakultetin e Bujqësisë në Sarajevë. Karrierën e gazetarisë e filloi në emisionet për bujqësinë në Radio Prishtinë, prej nga kaloi në Televizionin e Prishtinës (TVP), si përgjegjës i redaksisë së emisioneve dokumentare. Për një kohë të gjatë punoi redaktor i emisioneve për bujqësi dhe fshat. Ishte një nga themeluesit e revistës “Agrokultura” dhe bashkëpunëtor i shumë gazetave dhe revistave në Kosovë dhe jashtë saj. Ishte delegat i Kuvendit të Kosovës në shpalljen e Deklaratës Kushtetuese dhe miratimin e Kushtetutës së Kaçanikut (1990). Një kohë jetoi në emigrim. (Nehat Islami)

KELMENDI Ramiz (1930-2017). Shkrimtar, gazetar, profesor. Lindi në Pejë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, shkollën e mesme për bujqësi në Prishtinë, ndërsa studimet



RAMIZ KELMENDI

albanologjike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. Studimet pasuniversitare i kreu në Prishtinë. Punoi si mësimdhënës në Gjakovë, pastaj gazetar në “Rilindje”, redaktor në revistën “Zani i rinisë”, kryeredaktor në Redaksinë e botimeve “Rilindja”, drejtor i Teatrit Popullor Krahinor dhe mësimdhënës në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Me shkrime filloi të merrej që nga moshë rinore, duke filluar të botonte tregime prej vitit 1954, duke kultivuar më pas zhanre të ndryshme, si romane, tregime, novela, drama, radiodrama, satira, drama televizive, shkrime kritike, fejtone, reportazhe, monografi, lojëra skenike, përshkrime udhëtimi, recensione etj. Ishte bashkëpunëtor i rregullt i revistave dhe gazetave të Kosovës, ku botoi një numër të madh skicash humoristike, reportazhesh, refleksesh të ndryshme publicistike etj. Është gjithashtu bashkautor i disa botimeve, redaktor, përpilues tekstesh shkollore, si dhe ka përkthyer rreth dhjetë vepra letrare, kryesisht autorë të njohur të letërsisë botërore dhe jugosllave. Veprat e tij kryesore: “Vija e vrragë” (1958), “Dy rrëfime” (1962), “Letra prej Ulqini” (1966), “Heshtja e armëve” (1971), “Ahmet Koshutani” (1972), “Abrakadabra” (1974), “Njerëzit dhe kërmijtë” (1978), “Shtatë persona e ndjekin autorin” (1974), “Tregimi ynë humoristiko-satirik” (1978), “Kapuç me mangë” (1990), “Shtegtimet e mia” (1982), “Fytyra dhe turinj” (1990), “Kokrra kripte” (1990), “Jeta erotike e shkrimtarëve shqiptarë” (1996) etj. Tregimet e R. Kelmendit janë përfshirë në shumë antologji nga letërsia shqipe e Kosovës. Kryevepra e tij konsiderohet romani “Shtatë persona ndjekin autorin”, ku autori shpalos jetën psikologjike dhe individuale të shtatë personave që merren me thashetheme për të tjerët. Këta njerëz janë smirëzinj, intrigues, etiketues kundër atyre që kanë suksese në jetën e tyre. Për veprën e tij letrare dhe publicistike, R. Kelmendi u nderua me çmime dhe mirënjohje. (Femi Cakolli)

KELMENDI Sadri A. (1934-2011). Shkrimtar. Lindi në Pejë. Mësimet e para dhe ato të mesme i kreu në Pejë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Universitetin

e Prishtinës. Punoi si mësues në shkollë të ndryshme fillore dhe të mesme. Në dy dekadat e fundit të jetës ishte editor i revistave për fëmijë “Zog mëngjesi” dhe “Mollëkuqja” në Prishtinë. Nga vitet ‘60 u mor me krijimtari publicistike dhe letrare. Shkroi poezi e prozë, për të rritur dhe për fëmijë. Me libra të botuar u paraqit gjatë viteve ‘90 të shekullit të kaluar. Nga botimet që la pas veçohen librat: “Teuta kthehet në parajsë” (1997), “Plagë pas plage” (2000), “Gjarpërueshe e shiut” (2001) etj. (Hasan Hasani)

KELMENDI Sahit (1959-). Futbollist. Nisi karrierën si futbollist në moshën 8-vjeçare në klubin e futbollit “Besëlidhja” të Prishtinës. Në moshën 11-vjeçare kaloi në KF “Prishtina”. Më pas luajti për “Flamurtarin” dhe sërisht për “Prishtinën”. I takon “brezit të artë” të Prishtinës. Në vitin 1982/83 arriti suksesin më të madh, duke qenë pjesë e skuadrës që u përfshi në garat në Ligën e parë të ish-Jugosllavisë. Një pjesë të karrierës e kaloi në Turqi, te skuadra “Adanaspor”, si dhe në Austri, tek ekipi “Lask Lins”. Pasi e mbylli karrierën si futbollist, u bë trajner i “Shkëndijës” së Llukarit dhe i “Besëlidhjes” për disa vjet. Ishte edhe anëtar i komisionit disiplinor në Federatën e Futbollit të Kosovës, kontrollor, vëzhgues, si dhe dhjetë vjet kryetar i komisionit për delegimin e gjyqtarëve. Në vitin 2013 nga Federata e Futbollit u shpall punëtor i mirë sportiv në Kosovë. Që nga viti 2010 është kryetar i klubit të futbollit “Besëlidhja”. (Florim Maliqaj)

KELMENDI Sali (1946-). Gazetar, politikolog. Lindi në Qyshk të Pejës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Pejë, ndërsa studioi për histori dhe arte dramatike në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Zagrebit, ku mbrojti edhe disertacionin në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ishte korrespondent i Televizionit të Prishtinës (TVP) në Nikozi, Jerusalem, Kajro, Damask dhe Bejrut. Në fund të viteve ‘80 ishte kryeredaktor i TVP-së. Gjatë viteve ‘90 ishte anëtar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (1990-1993), ndërsa punoi si redaktor në Televizionin Shqiptar, programi për Kosovën. Në cilësi të veprimtarit politik e humanitar përfaqësoi Kosovën në një sërë takimesh ndërkombëtare në Europë

dhe në SHBA. Nga viti 2005 punon ligjërues i lëndëve nga marrëdhëniet ndërkombëtare në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Botoi një sërë punimesh shkencore e publicistike në revista të ndryshme, shqip dhe anglisht. (Shaqir Foniqi)

KELMENDI Shyqri (1947-). Inxhinier i xehetarisë, profesor universiteti. Lindi në Mitrovicë. Shkollën fillor dhe të mesme i kreu në Mitrovicë, studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit (1970). Pas diplomimit punoi si inxhinier në minierën “Trepça” në Stantërg. Në periudhën 1971-1989 në kombinatin “Trepça” kreu një varg funksionesh drejtuese: drejtor



SHYQRI KELMENDI

i përgjithshëm i minierës me flotacion, drejtor i metalurgjisë së plumbit, drejtor i minierës në Stantërg etj. Në periudhën 1988-1991 ishte drejtor i minierave të “Ferronikelit” në Drenas. Në vitin 1991, me vendim të Serbisë, përjashtohet nga puna. Ishte aktiv edhe në procesin mësimor. Në vitin 1974-1976 mbajti mësim në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë, kurse më pas u angazhua në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë, fillimisht si asistent, e më pas si ligjërues dhe profesor për lëndë profesionale. Studimet e magjistraturës i vijoi në Universitetin e Beogradit (1986-1989), kurse doktoroi në Universitetin e Prishtinës (2003). Në periudhën 2005-2008 ishte këshilltar në Ministrinë për Energji dhe Miniera të Republikës së Kosovës. Sh. Kelmendi është autor i një sërë punimesh profesionale-shkencore të botuara në revista vendore dhe ndërkombëtare. Është anëtar i Akademisë Ballkanike të Shkencave për minerale me seli në Stamboll. (Minir Dushi)

KELMENDI Tafil (1948-1993). Gjuhëtar. Lindi në Balincë të Klinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Prishtinë. Në Prishtinë mbaroi edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Këtu vazhdoi studimet pasuniversitare dhe më 1981 mori gradën e magjistratit të shkencave filologjike, ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti më 1988. Më 1975 u zgjodh asistent i sintaksës e më vonë, më 1978, ligjërues i morfologjisë dhe i sintaksës

në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Specializoi në Paris. Botoi një numër studimesh dhe artikujsh për normën e gjuhës letrare dhe strukturën morfologjike e sintaksore të shqipes, kryesisht lidhur me sistemin foljor. Botoi studime për paskajoren, për funksionet semantike të dëshirores, për kohët e foljes dhe njësitë tekstore, për aspektin etj. Monografitë e tij të botuara pas vdekjes janë: “Funksionet e kohës së pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare” (1994), “Kështjellat e sintaksës (Kohë foljore dhe njësi tekstore)” (2006) etj. (Agnesa Hasimja)

KELMENDI Zejnel (1937-). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe vaskular, profesor universiteti. Lindi në Preshevë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Prishtinë. Kreu Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb (1964). Filloi punën në shërbimin primar shëndetësor në Gjilan, e nga viti 1969 kaloi në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë. Specializimin për kirurgji të përgjithshme e filloi në Prishtinë dhe e përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Për aftësim në lëmin e kirurgjisë vaskulare qëndroi në Pragë dhe Gjenevë. Mbrojti temën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë më 1980. Më 1972 u angazhua në procesin mësimor në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, së pari u zgjodh asistent dhe më vonë arrin deri në gradën e profesorit të rregullt të kirurgjisë së përgjithshme dhe luftarake. Në periudhën 1991-1996 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë, ndërsa prej vitit 1997 ishte rektor i Universitetit të Prishtinës. Pas pensionimit i akordohet titulli profesor emeritus. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale. Ka qenë aktiv në lëvizjen politike të viteve '90 dhe ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. (Avdyl Krasniqi)



ZEJNEL KELMENDI

KELMENDI Zymber (1977-). Skenarist, mësimdhënës universiteti. Lindi në Vajnikë të Skënderajt, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për dramaturgi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2003). Po në degën e dramaturgisë të këtij fakulteti ligjëron lëndën e skenarit të

filmit dhe të televizionit. Është autor i një numri skenarësh për filma të metrazhit të shkurtër: “Vdekja solemne”, “Ora e madhe”, “Tri dritare”, “Kohë e bukur për të vdekur”, “Aida” etj. Është autor i skenarit të filmave artistikë të metrazhit të gjatë “Tri dritare dhe një varje” (2011), “Home Sweet Home” (2014) dhe “Kënga e perëndimit” (2015). Me skenarët “Tri dritare dhe një varje” dhe “Home Sweet Home” është fitues në konkursin vjetor të Qendrës Kinematografike të Kosovës. Për skenar mori disa çmime në festivale dhe manifestime të ndryshme, si çmimin kryesor në kategorinë “Work in Progress” në Festivalin e Filmit të Sarajevës (2013), pastaj çmime në festivalet ndërkombëtare në Turqi, Izrael dhe SHBA (2015). (Besim Rexhaj)

KELTËT. Një nga popullsitë e mëdha të antikitetit, që banonte pjesën më të madhe të Europës Qendrore. Keltët quhen edhe galë. Gjatë periudhës La Tène (450-450 p.e.r.) kultura kelte u shtri në pjesën më të madhe të Europës, duke përfshirë territoret e sotme të Francës, Portugalisë, Italisë së Veriut, Hungarisë, Anglisë Jugore, Irlandës etj. Dy fise të mëdha kelte, skordiskët dhe bastarnët, u vendosën në verilindje të Dardanisë, ndërsa keltët e tjerë u përzier me fisin ilir të japodëve. Keltët u dyndën herë në territorin e Dardanisë. Në vitin 280 p.e.r. një ushtri kelte, pasi përshkoi Maqedoninë dhe grabiti Delfin, u përpoq të kthehej përmes Dardanisë, por u asgjësua plotësisht. Në vitet 177-175 p.e.r. u zhvillua lufta dardanebastarne. Të nxitur nga mbreti i Maqedonisë, Perseu, bastarnët ishin dyndur në Dardani dhe kishin pushtuar një pjesë të saj. Mbreti dardan Monuni, i biri i Longarit, mobilizoi gjithë forcat dhe arriti t'i shkatërrojë në betejën vendimtare të vitit 175 p.e.r. Mercenarët keltë përbënin garnizonin prej 800 luftëtarësh që ia dorëzuan ushtrisë ilire të mbretëreshës Teuta kryeqytetin e Epirit, Foinikën, kundrejt një shpërblimi (230 p.e.r.) (Neritan Ceka)

KENOZOIKU. Erë më e re e historisë gjeologjike të Tokës, që vijon pas mesozoit, duke filluar para 66 milionë vitesh, përfshin edhe kohën e sotme, gjatë së cilës janë formuar shkëmbinjte që përbëjnë eratemin kenozoik. Ndahet në periudhat: terciar (paleogjen e neogjen) dhe kuaternar. Kenozoiku shquhet nga mbyllja graduale e oqeanit Tetis dhe nga krijimi në vend të tij të pellgjeve të sotme

ndërkontinentale, si Mesdheu, nga vazhdimi i hapjes së Oqeanit Atlantik nga lëvizjet e fuqishme tektonike të ciklit malformues alpin, nga dukuri të shumta magmatike e vullkanike. Në këtë erë bota organike ka pësuar ndryshime të theksuara. Në botën organike të kenozoikut spikat zhvillimi i madh i gjitarëve, peshqve, zogjve, foraminiferëve, moluskëve, i bimëve të larta farëveshura e gjetherënëse dhe i algave karbonatike e silicore etj. Gjatë neogjenit në stere përhapen shumë mishngrënësit, kurse në kuaternar (antropogjen) bota organike arrin kulmin e zhvillimit të saj me paraqitjen e njeriut. Gjatë kenozoikut u formuan vargjet e rrudhosura alpine mesdhetare dhe harku Dinarid-Albanid-Helenid, si pasojë e afrimit të pllakës europiane dhe asaj afrikane (rrudhosja alpine). Në faza të ndryshme të ciklit malformues alpin dolën mbi ujë dhe u kthyen në tokë treva të gjera që mbuloheshin nga deti dhe që tanimë ishin formuar si zona të veçanta paleogjeografike. Këto lëvizje kanë prekur edhe territorin e Kosovës, Janë formuar fushëgropat tektonike të Dukagjinit, Drenicës, Kosovës dhe Moravës së Binçës, si dhe janë depozituar sedimente të trasha të molasave dhe ka ndodhur një aktivitet i fuqishëm vullkanik i terciarit, përfshirë edhe krijimin e masave të mëdha të andeziteve, daciteve, trahiteve etj. Më tej kanë vazhduar lëvizjet tektonike, që kanë sjellë ngritje të mëtejshme të trevave malore, si dhe veprimtaritë gërryese të rrjetit hidrografik, i cili modeloi relievin e sotëm. Në kuaternar, pjesët e larta malore u përfshinë nga akullzimet. Gjatë kenozoikut janë formuar një pjesë e mirë e shtratimeve dhe vendburimeve të mineraleve të dobishme, siç janë: vendburimet e plumbit, zinkut, argjendit dhe të arit (Stan Tërg, Artanë, Kishnicë etj.), të magnezitit (Strezoc), të qymyrit (linjtit) në Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit, të nikelit silikat (Drenicë) etj. (Gani Maliqi)

KEQEKOLLA. Fshat në verilindje të Prishtinës, rreth 22 km nga qendra. Është vendbanim kodrinor-malor i tipit të shpërndarë. Gjurmët arkeologjike dhe toponimet në ngastrën e fshatit dëshmojnë për vjetërsinë e vendbanimit. Gjatë viteve 1877-1878 këtu vendosen familjet shqiptare të muhaxhirëve të dëbuar nga sanxhaku i Nishit. Deri në vitin 1999 fshati kishte 171 shtëpi me rreth 1,200 banorë. Është bashkësi lokale dhe qendër e disa

vendbanimeve përreth. Ka dy shkolla fillore, qendren e mjekësisë familjare, bibliotekën, shtëpinë e kulturës, stacionin e veterinarisë, fabrikën e përpunimit të kafes dhe disa njësi tregtare. (Skender Halimi)

KERQUKI Leonard (1981-). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gazetari në Prishtinë. Punoi gazetar në gazetën “Lajm”, në gazetën “Express” dhe në disa revista dhe radio lokale. Në gazetën “Express” për një kohë të gjatë ishte redaktor i politikës, ndërkaq nga viti 2010 kryeredaktor i saj. Punoi edhe në Televizionin “Klan”. Pas vitit 2013 udhëhoqi portalin “Gazeta Express”, duke e bërë medien online më të madhe në Ballkan. Ishte anëtar i bordit të Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës. Përveç kryeredaktor i portalit “Gazeta Express”, është producent i disa emisioneve televizive që prodhon kompania “Media Works” dhe njëri nga drejtuesit e emisionit “Komiteti”. (Ibrahim Berisha)

KËNDIMI IM I PARË. Abetarja e parë shqipe për nxënësit e shkollës fillore në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, botuar në shtypshkronjën “Luarasi” Prizren-Tiranë, më 1945, pa emër autori. Ka 80 faqe dhe ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë ka shkronjat e mëdha të shtypit, në pjesën e dytë janë paraqitur shkronjat e vogla të shtypit. Ka edhe 60 tekste, 12 poezi, 9 gjëgjëza dhe 2 dialogë. Përmbajtja e abetares shoqërohet me ilustrime bardh e zi. Me këtë tekst shkollor fillon një etapë e re në historinë e abetaresve shqipe në Kosovë. (Valentina Nimonaj-Hoti)

KËNGËT DHE RITET E MOTMOTIT. Krijime folklorike me origjinë pagane, që lidhen me ndërrimin e stinëve në natyrë dhe me synimet e njeriut që ta shfrytëzojë atë për një jetë më të lehtë dhe më të begatshme. Gjatë festave pagane ritet janë shoqëruar edhe me këngë, përmes të cilave urohet shëndet, mbarësi, shtim i fisit dhe pasuri, të korra dhe të vjela të mbara, për jetë të gjatë, për shumë djem dhe për martesë të reja dhe të lumtura. Karakteri i çdo feste të motmotit, i kolendrave, i ditës së buzmit, i vangjelzmoit, i ditës së verës, i Shëngjergjit etj. ndryshon sipas stinës, por prapëseprapë, për nga urimet dhe zakonet, mbesin pothuajse të njëjta. Në të gjitha këto

festa gatuhën kuleç e lakror ose ëmbëlsira, ndizet zjarr, këndohet e vallëzohet dhe shkohet te njëri-tjetri për urime. Këngët që shoqërojnë ritet periodike në zanafillën e tyre duhet të kenë pasur karakter erotik, pasi njeriu i atëhershëm besonte se edhe në këtë mënyrë do të mund të ushtronte ndikim magjik në frytnimin e tokës me diellin, në frytnimin e pemëve dhe në shtimin e bagëtisë. Këngët e motmotit në folklorin tonë janë shënuar shpesh si fragmentare, pasi edhe ritet janë zvetënuar. Këngët e punës janë botuar deri tash në shumë vëllime të poezisë popullore lirike. Ato janë ende të pranishme dhe performohen edhe në festivalet tona folklorike, si në Drenas dhe në Gjirokastër. (Ylberza Halili)

KËNGËT E DASHURISË. Lloji veçantë i lirikës popullore, që ka shtrirje të gjerë në krijimtarinë gojore. Konsiderohet poezi e mirëfilltë lirike, sepse u kushtohet ndjenjave sublime të të rinjve të dashuruar. Është e përhapur si në mjediset rurale, ashtu edhe në ato urbane. Këngët e mjedisëve rurale të Kosovës fillojnë rëndom me shprehjet e përhershme “Moj e mira...” dhe këndohen kryesisht nga barinjët në natyrë. Në disa zona malore të Shqipërisë së Veriut, sidomos në Theth, pastaj edhe në Plavë, Guci e në Rugovë, këngë dashurie këndojnë edhe vajzat. Në to shprehin drejtpërdrejt me një ndjeshmëri të theksuar ndjenjat dhe dëshirat e të rinjve, kryesisht djemve, për takime dhe kënaqësi dashurie me të dashurat e tyre reale ose të imagjinuara. Këngët e dashurisë nga mjediset urbane janë më të ndjeshme dhe flasin për një dashuri platonike, me ngrohtësi dhe spontanitet, ku krahas ndjenjave përshkruhet deri në hollësi bukuria e vajzës dhe dëshira që ajo të përvetësohet. Këto këngë shquhen për figuracion të pasur. Këngët e dashurisë janë mbledhur që herët nga mbledhësit e njohur të folklorit shqiptar, ndërsa botimi më i plotë i këtyre këngëve është bërë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës (1987). (Krenar Doli)

KËNGËT E FËMIJËVE. Lloji veçantë i poezisë lirike popullore, i krijuar nga fëmijët ose nga të rriturit për fëmijët. Këngët kanë një ritëm të veçantë dhe interpretohen kryesisht në formë recitative, shpesh edhe me fjalë pa kuptim të veçantë. Recitohen gjatë lojës së fëmijëve, si akte numërimi para fillimit të ndonjë loje. Krahas përbërësve lirikë që e

karakterizojnë pikënisjen e këtyre poezive dhe praninë së dukshme tregimtare në disa lloje të tyre, në këto këngë përfshihen edhe përbërësit dramatikë. Për nga origjina, këto këngë shënojnë fillimet e hershme mitike të formulave magjike, që interpretoheshin nga të rriturit dhe që u kushtohen kryesisht dukurive të natyrës, ndërsa sot kanë mbetur si krijime të fëmijëve. Të këtilla mund të konsiderohen edhe disa nga këngët e festave të motmotit. Dallohen edhe këngët e barinjve dhe bareshave të vogla, që këndohen duke kullotur bagëtinë, pastaj këngë të veçanta të vajzave që këndohen me gisht në fyt ose në kolovajzë gjatë festave dhe argëtimeve të tjera. Disa nga krijimet e këtilla recitohen edhe në formë të dialogëve, gjëgjëzave, prandaj quhen edhe lojëra të vatrës, që përfaqësojnë format më të thjeshta të dramave popullore. Këngë të fëmijëve kanë botuar edhe mbledhësit e hershëm të folklorit shqiptar, si: Th. Mitko, S. Dine, V. Prenushi, si edhe disa nga të huajt, si Hani, Majeri etj. (Sadri Fetiu)

KËNGËT E KOMPOZUARA KORALE. Janë kompozime muzikore për koral, me apo pa shoqërim instrumental. Historikisht të kënduarit koral si formë e të kënduarit kolektiv njihet që në lashtësi, për të ardhur më pas në Koralin Gregorian monodik (me një zë) dhe a capella të Mesjetës. Gjatë Barokut të kënduarit koral u zhvillua drejt procedurave të reja harmonike dhe tonale, si dhe drejt poezive me tematika më laike. Në periudhat në vazhdim (klasicizmi, romantizmi) gjinitë e të kënduarit koral zunë një vend të rëndësishëm jo vetëm në muzikën fetare, por dhe në atë laike, duke pasqyruar idetë e kohës. Një përhapje të gjerë gjeti të kënduarit koral në shkollat e reja nacionale muzikore të lindjes (Dvorzhak, Korsakov, Grig, Çajkovskij, Rahmaninov, etj.) në forma gjithnjë e më të lira e të larmishme. Kultura muzikore e botës komuniste lindore ndikoi me diferenca të vogla në kulturën muzikore shqiptare. Në pikëpamje të organikës vokale këngët korale mund të kompozohen për kore femrash (Soprano dhe Alto); kore burrash (Tenor dhe Bas-Bariton); kore të përziera (femrash dhe burrash) dhe për kore fëmijësh. Në trevat shqiptare kënga korale është lëvruar që nga dekadat e para të shek XX, fillimisht me karakter patriotik e popullor. Në Kosovë nga të parët krijues të këngës korale, mbi

motive popullore, në formën e harmonizimeve, stilizimeve apo përpunimeve ishte kompozitori Lorenc Antoni. Shquhet përmbledhja me këngë korale “Jehona të zemrës” (1958), suita për kor të përzier “Opojanja” etj. Pas tij një sërë krijuesish kanë dhënë kontribut në këtë gjini, si R. Mulliqi, V. Gjini, M. Kaçinari, E. Rizvanolli, F. Beqiri, A. Koci, Z. Ballata, R. Dhomi, R. Rudi, B. Mulliqi, B. Jashari etj. Megjithëse lidhja me motivet e meloditë folklorike mbeti karakteristike e muzikës korale në Kosovë, dekadat e fundit të shek. XX dhe ato në vazhdim paraqesin evoluim të spikatur stilistik të krijimtarisë së kësaj gjinie muzikore. (Nestor Kraja)

KËNGËT E KURBETIT (MËRGIMIT). Krijime gojore tradicionale, poetike e muzikore, që kanë për temë largimin e detyrueshëm nga vendlindja ose atdheu për shkaqe ekonomike, politike dhe sociale. Si këngë të mërgimit ndonjëherë janë identifikuar këngët që i janë kushtuar migrimit masiv, ndërsa këngë të kurbetit janë quajtur këngët që i kushtohen emigrimit individual. Këngët më të vjetra të mërgimit janë ato të arbëreshëve të Italisë, të cilat konsiderohen ndër krijimet më të bukura të folklorit shqiptar (“Moj e bukura More” etj.). Kujtesa kolektive ka regjistruar periudha të caktuara të mërgimit të detyruar të shqiptarëve në anë të ndryshme të botës: mërgimi në kohën e Perandorisë Otomane në Italinë e Jugut, në Stamboll, në Misir (Egjypt), në Bullgari e në Rumani, gjithashtu më pas në Greqi e në Rusi. Më e vonë mërgimi në Amerikë, në Argjentinë dhe në Australi, më pas shpërngulja masive e shqiptarëve për në Turqi. Këngët e kurbetit paraqesin lloj të veçantë të këngëve lirike, ku lirizmi merr një trajtë specifike të shprehjes së ndjenjave, të mallit e të mungesës jo vetëm të kurbetçinjve, por edhe të prindërve, nuseve, fëmijëve e farefisit. (Arbnora Dushi)

KËNGËT E NIZAMËVE. Krijime të poezisë popullore lirike, që shquhen për ndjeshmëri dhe vlera të veçanta artistike. Këngët i përkasin një periudhe të caktuar historike, që ka të bëjë me gjendjen e krijuar në viset shqiptare, si pasojë e masave që kishte marrë Porta e Lartë me Reformat e Tanzimatit (1839). Njëra nga këto masa ishte rekrutimi i detyrueshëm i të rinjve shqiptarë në radhët e ushtrisë osmane. Nizamët, si ushtarë të rekrutuar me forcë nga pushtetit osman, shërbenin në ushtri prej 5-7 vjet, duke

përballuar një jetë të rëndë dhe plot rreziqe, shpesh pa shpresë të kthimit në vendlindje. Këngët i kanë krijuar kryesisht ushtarët e dërguar në vise të largëta të Perandorisë Osmane dhe, si të tilla, kishin një përhapje më të kufizuar në krahasim më këngët e tjera lirike. Përmes këtyre krijimeve, që konsiderohen edhe balada të mirëfillta, nizamët përçonin vuajtjet dhe mallin si të ushtarëve, ashtu edhe të familjarëve të tyre, sidomos të nënave dhe të nuseve të reja. Këngët më të dhimbshme dhe me vlera më të shquara artistike janë: “Mbeç, ore shokë, mbeç”, “Ndër dy male me dëborë”, “Dal në brek e vështroj fshanë”; “Ju nizamë të hupun e të tretun”, “Këto nizamët e Shqiptarisë” etj. Këngët e nizamëve janë botuar edhe në vëllime të veçanta folklorike, bashkë me këngët e kurbetit. (Vlorë Fetaj-Berisha)

KËNGËT E PËRPUNUARA KORALE. Këngë të përpunuara për kor të përzier, por dhe për kor meshkujsh e femrash, si dhe për kore femijësh. Në fillim është bërë përpunimi i këngëve popullore, por më pas këngët janë kompozuar mbi tekste poetike. Krahas, popujve të tjerë, edhe ndër kompozitorët shqiptarë është filluar me harmonizime e përpunime korale të këngëve popullore apo fetare, si Fan S. Noli (psalme, himne korale), Martin Gjoka, Shime Deshpali (“Dashnor t’u bana”, “O ky Mehmeti”), Thoma Nasi, Lorenc Antoni (“Kur më del në derë”, “Ani mori nuse”, “Ani moj Hatixhe”, “Na ka dalë nusja e mirë”, “Shkojti çika”, “Kënga e Rexhës”, “Mirëmbrama”, “Hajde dalim kah pazari”, “Çorapët e burrit”, Ç’janë këta krushq”, suita “Opojanja” me këngë nga ana e Opojës, “Shendi ulqinak” etj.), Eftim Dheri, Çesk Zadeja (“Shkon djali termal”), Milto Vako, Feim Ibrahim, Mark Kaçinari (“Zogu i Ohrit”, “Shamikujta”, “Mori trandofilla e vogël”), Vinçenc Gjini, Krist Lekaj (“Unë ty moj të kam dashtë”, “Pranvera e bukur”, “Besa-besë”, “Si dukat i vogël je”), Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri (“Erdh misiti”, “Moj e mira”), Zeqirja Ballata (“Ku po shkon moj goçë vogël”, “Si dukat i vogël je”, “Kam shtëpinë me thupra”, “Kopilja dhe Skanderbeku një mënatë”), Rauf Dhomi (“Te mullini përmbi vijë”, “O po gjeta një bilbil me vesë”, “U çu Rrushja”, “Kur del hana”, “Bakushja”, “Ç’është ajo”, “Ke dalë te porta”, “Korçares”, “Ky fustan” etj.), Kujtim Laro, Rafet Rudi (“Ishin dy kunata”), Gjergj Gjevelekaj, Menduh Mengjiqi etj. (Zeqirja Ballata)

KËNGËT E PUNËS. Lloji i lirikës popullore me origjinë të hershme, si nxitje që të kryhet puna më lehtë dhe të jetë sa më e dobishme. Në këto këngë hetohet një afrim i madh i njeriut me natyrën, me botën bimore, veçmas me kafshët, të cilat janë pjesë e pandashme e procesit të punëve të ndryshme, veçmas në bujqësi e blegtori. Ndër krijimet më të vjetra janë këngët për mbledhjen e bletëve dhe ato për fshirjen e drithërave, si dhe këngët për punët e grave në amvisni. Në disa këngë mallkohet varfëria, puna e rëndë që kryhet nëpër ara, vuajtja dhe skamja. Jo rrallë këto këngë kanë një ton shpotitës, plot humor, si mënyrë për të përballuar vështirësitë dhe për të kultivuar shpresën për të ardhmen më të mirë. Ka këngë të punës që u kushtohen edhe profesioneve të ndryshme, si: çobanit, mullixhiut, kallajxhiut etj. Në to puna e tyre paraqitet me tone humoristike, por përherë me afeksion, pasi profesionet e tyre janë të nevojshme për mjediset e caktuara. Këngët e punës janë botuar në shumë përmbledhje, në Tiranë dhe në Prishtinë. (Ylberza Halili)

KËNGËT EPIKE HISTORIKE. Lloji i poezisë epike, që ka për subjekt ngjarjet historike, që nga periudha e hershme e mesjetës e deri në ditët tona. Janë një kronikë poetike e ngjarjeve të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar. Krijimet më të vjetra të epikës sonë historike i përkasin Luftës së Kosovës të vitit 1389, të cilat kanë disa veçori origjinale dhe ndryshojnë nga këngët sllave me këtë tematikë. Më pas vijnë këngët historike që lidhen me periudhën e dy pashallëqeve të mëdha shqiptare, të Shkodrës dhe të Janinës, pastaj të periudhës së Tanzimatit dhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në të cilat portretizohen heronjtë popullorë të lëvizjes kombëtare për liri dhe mëvetësi kombëtare. Këngët historike i kanë trajtuar edhe një sërë ngjarjesh dhe kryengritjesh, që i kanë paraprirë shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar më 1912, pastaj luftërat ballkanike, në mënyrë të veçantë luftën për mbrojtjen e Shkodrës dhe të një varg ngjarjesh në kuadër të lëvizjes së kaçakëve, të udhëhequr nga luftëtarët popullorë, si: Azem e Shote Galica, Nak Berisha, Qorr Iliazi, Sali Shabani, Kamer Loshi e shumë të tjerë. Këtu bëjnë pjesë edhe këngët kundër kolonizimit, pastaj ato kundër shpërnguljes për në Turqi me heronj të dalluar, si: Ahmet Shtimja, Hoxhë Breznica, Xunë Mamusha, Rrahman Dedija, Ramë Bllaca etj. Këngët

historike i kanë trajtuar edhe ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, si edhe aktivitetet atdhetare gjatë gjithë periudhës së ish-Jugosllavisë. Epika historike ishte edhe një lloj kronike e ngjarjeve të luftës së UÇK-së. Këngët e periudhës më të re janë bazuar në strukturën kompozicionale të epikës së traditës dhe në vargun e njohur tetërrokësh. Këngët epike historike janë botuar në vëllime të veçanta si në Tiranë, ashtu edhe në Prishtinë. (Sadri Fetiu)

KËNGËT EPIKE LEGJENDARE. Lloji veçantë i poezisë popullore, që shquhet për efektet e veta fantastike e mitike. Personazhe të këtyre krijimeve poetike janë shpesh edhe qeniet e besimeve popullore. Mrekullia, legjendariteti, hiperbolizimet janë karakteristike për këngët legjendare të ciklit të kreshnikëve, Mujit, Halilit, tridhjetë agëve të çetës së tyre, për ciklin e këngëve heroike të Gjergj Elez Alisë, por edhe për baladat e shumta të tipit legjendar. Këngët epike legjendare të mbledhura në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare kanë përbërës të ngjashëm më përrallat popullore. Këngët epike legjendare qoftë si njësi të eposit të kreshnikëve, qoftë edhe si balada dëshmojnë për fuqinë e shpirtit të fshehur në qenie të tjera, për fuqinë e tabuve, si edhe për forcën emocionale të njerëzve që i tejkalojnë edhe situatat e pamundshme të jetës dhe vdekjes, për ta përmbushur detyrën, për të ngadhënjyer simbolikisht me anë të metamorfozimit në qenie të tjera ose për të dëshmuar vazhdimësinë e jetës në forma të ndryshme simbolike. Legjendariteti apo ndodhitë e mrekullishme mitike e magjike të këngët epike legjendare janë në funksion artistik dhe i shërbejnë paraqitjes më emocionale të këtyre krijimeve poetike me origjinë të hershme. Këngët legjendare të ciklit të kreshnikëve përcillen më së shpeshti me lahutë, kurse ato që janë balada të mirëfillta ndodh që, përpos me lahutë, të përcillen edhe me vegla frymore, si: fyelli, kavalli, gajdja, okarina etj. Epika legjendare është botuar në vëllime të veçanta në Tiranë dhe në Prishtinë. (Sadri Fetiu)

KËNGËT EPIKE TË MESHKUJVE. Kryesisht janë të lidhura me lahutën dhe më pas me çiftelinë e sharkinë. Përfaqësimin më të plotë e konstatojmë tek Eposi i Kreshnikëve, që shfaqet si një cikël këngësh epike legjendare i shoqëruar me lahutë, me në qendër vëllezërit

Muji e Halili. Eposi këndohet në Malësinë e Madhe, në Rranzat, Postrinë, Shllak e Dukagjin, Nikaj-Mërtur, Krasniqe e Gash, Bytyç, Berishë, Has dhe në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit me qendrat: Pejë, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Deçan, Istog e Suharekë. Koha e formimit të tij lokalizohet të jetë përpara dyndjes sllave në Ballkan, pra parasllav e paraturk. Skema e ndërtimit të vargjeve është e mbështetur në vargjet 6-, 8-, 10-, 14- dhe 16-rrrokëshe, mbi shkallët muzikore modale diatonike me ton e gjysmëton. Për shumë studiues, vlera e tyre krahasohet me eposin homerik, sagat e Skandinavisë, Kalevalën, Bilinat ruse etj. Nga shumë studiues janë vënë re dhe ngjashmëritë e eposit tonë me poemat homerike. Eposi është kënduar vetëm në odat e miqve, në kuvendet e burrave, në festa, pa stimuj materialë për rapsodët, si kategori e muziktarëve popullorë, të lidhur ngushtë me këngëtimin e “Eposit të Kreshnikëve”, të epikës legjendare në përgjithësi, por dhe më gjerë. Ndër rapsodët e njohur në muzikën tonë popullore përmendim: Sali Bajram Krasniqi (Kosovë), Vat Marashi (Pukë), Prendush Gega, Selim Hasani (Vlorë), Dervish Shaqa (Kosovë), Mato Hasani (Vlorë), Xhebro Gjika (Vlorë), Zef Avdia (Tropojë) dhe Sokol Arifi (Tropojë), Lefter Çipa (Himarë), Frrok Haxhia (Pukë), Sali Mani, Azis Ndreu, Fatime Sokoli, Xhelal Daka etj. Ndër këngët e veçanta të ciklit përmendim: “Martesa e Mujit”, “Fuqia e Mujit”, “Orët e Mujit”, “Vaji i Ajkunës”, “Martesa e Halilit”, “Muji e tri zanat e malit”, “Halili pret Pajo Harambashin”, “Orët e Bjeshkës” etj. (Vasil S. Tole)

KËNGËT HUMORISTIKE. Lloji i veçantë i këngëve popullore lirike, me elemente të humorit dhe të qeshurës. Në krijime të këtyre poetike vihet në lojë apo kritikohet lehtë një person apo një dukuri që është e papranueshme. Kënga humoristike është e përhapur në folklorin e të gjitha trevave shqiptare. Ato kanë shtrirje në shumë lloje të lirikës, duke filluar nga këngët shpotitëse të fëmijëve, këngët humoristike të dasmës, këngët e punës, këngët e dashurisë etj. Në mënyrë të veçantë humori dhe satira janë të pranishme në këngët e kapuçave e të filxhanëve. Këngët kanë vargje plot humor, përqeshje dhe shpotitje satirike, që arrijnë gradualisht deri te sarkazmat, por pjesëmarrësit në këto lojëra nuk hidhërohen e as nuk grinden, kur janë objekt i këtyre

këngëve. Si të veçanta janë mbledhur dhe janë botuar në kuadër të vëllimeve me këngë të ndryshme popullore. (Krenar Doli)

KËNGËT LIRIKE TË FEMRAVE. I përkasin lirikës familjare të dashurisë, fejesës dhe atyre të dasmës. Në këngët e lirikës familjare, kryet e vendit i zënë ninullat, të njohura dhe si “nina-nana”. Janë këngë popullore që u këndohen fëmijëve në djep, kryesisht nga nënat. Ndërtohen në ritme dy e tre pjesëtuese, për shkak të melodikës së thjeshtë që mbartin, kjo e kushtëzuar nga lëvizja ritmike e djepit. Në Jug ndërtohen mbi shkallët pentatonike, ndërsa në Veri mbi modet diatonike. Në pikëpamje të formës ndërtohen mbi një fjali që përsëritet më pas me variacione. I gjejmë edhe me emërtimin këngë djepi në të gjitha rastet kur këto këngë lirike popullore me një zë u këndohen fëmijëve deri në moshën 1-vjeçare të kënduara nga gratë, nënat, gjyshet, por edhe nga vajzat e rritura. Ndërtohen me një ambitus brenda oktavës, në ritme dy ose tre pjesëtuese dhe përgjithësisht në monodi. Me emërtimin “këngë të thmive” i gjejmë në Podgur, Kosovë, kurse te shqiptarët e Maqedonisë edhe me “luli-lulat”. Një tip i veçantë i këngëve lirike të kënduara nga femrat janë dhe “këngët me tepsi”: këngëtarja shoqëron melodinë e këngës që e këndon vetë me një tepsi që e rrotullon pareshtur deri në fund të këngës. Zakonisht tepsia është prej bakri dhe rrotullohet mbi një sofër buke. E gjejmë të përhapur në Malësitë e Veriut, Plavë, Guci, Rugovë etj. (Vasil S. Tole)

KËNGËT MALËSORÇE. Këngë kushtrimi të malësorëve në veri të Shqipërisë, që e kryejnë funksionin e zëdhënies. Njihen në popull edhe si këngë majekrahu, këngë përmajekrahu, këngë përkryekrahu, këngë termalçe, këngë piskë, këngë me gisht në vesh, këngë përpjetë, këngë tërthorçe, madje dhe asqerçe. Emërtimet nisen kryesisht nga mënyra e interpretimit, ose nga qëllimi i kryerjes së saj. Sipas E. Koliqit, këngët maje-kraje, malësorçe, thirren nga malësorët edhe si këngë të egra. Në Ciklin e Kreshnikëve e hasim si këngë me gisht në vesh. Sipas R. Munishit, lidhur me përhapjen e tyre në Kosovë, ato i gjejmë më të theksuara në Malësinë e Madhe të Mbishkodrës, në trevat e Trieshit, të Hotit, të Grudës, në rrethin e Plavës e të Gucisë, në Rugovë, në Malësinë e Gjakovës dhe në Podgur të Pejës e të Istogut. Në Kosovë, në fshatin Piranë, është gjetur një figurinë

bronzi, që duket se është një këngëtar në pozicionin maje krahu. Në Shqipërinë e Veriut i hasim në Has, në rrethin e Kukësit, Pukës, në disa fshatra të Mirditës, të bregut të Matit e pjesërisht në rrethin e Lezhës. Këndohen edhe te shqiptarët në Mal të Zi, ku njihen kryesisht si këngë barinjsh. Ekziston edhe një repertor i kënduar i këtyre këngëve deri diku të çliruara nga karakteri utilitar paraprak. Shkallët muzikore janë modale, kryesisht të tipit diatonik, por edhe kromatik. Këndohen solo, por në raste edhe nga dy këngëtarë. (Vasil S. Tole)

KËNGËT MONODIKE DHE HETERO-FONIKE. Këngët janë gjinia më demokratike e folklorit muzikor shqiptar. Në viste shqiptare këngët i gjejmë me ose pa shoqërim me vegla muzikore popullore dhe i kemi të ndërfutura që në këngët e djepit e deri te gjëma. Kënga shquhet për strukturën e thjeshtë të ndërtimit të saj (zakonisht strofë-refren), por dhe për forcën e madhe komunikuese të melodisë së saj. Zakonisht këngët në jug të Shqipërisë zgjasin deri në kufirin e 3 minutave. Në ahengun shkodran gjejmë këngë deri në 5 minuta. Në Veri e gjejmë në formën kajkë. Tek arbëreshët e Italisë në formën kangjelë dhe këndimëz. Në jug të lumit Shkumbin kemi këngët isopolifonike, në veri të Shkumbinit këngët/kangët njëzëshe. Sipas R. Sokolit, atje ku flitet në dialektin gegë kemi muzikë homofonike-monodike. Me monodi kuptojmë të kënduarit e një linje të vetme melodike, nga një këngëtar ose një grup këngëtarësh. E rëndësishme në këtë rast është që të jetë vetëm një linjë melodike. Në rastet kur kemi një këngëtar ose grup këngëtarësh që këndojnë një linjë melodike dhe shoqërohen nga një vegël ose grup veglash muzikore, e quajmë monodi me shoqërim. Vetëkuptohet që shoqërimi të jetë i tipit ritmik, harmonik e melodik. Këngë monodike tipike janë këngët malësorçe, këngët e shoqëruara me lahutë ose me çifteli. Populli thotë që “Kënga të lë në breg”, me kuptimin: mbetesh i varfër ose të lë të shquar. Një ndër botimet e para me transkriptime këngësh popullore monodike dhe heterofonike është libri “Kangë popullore shqiptare” (Moskë 1953). Ky botim u përgatit nga ish-studentët e Konservatorit të Moskës, Dhora Leka, Çesk Zadeja dhe Tish Daija. Libri përmban 30 këngë popullore të transkriptuara, të shoqëruara me tekstin shqip dhe përkthimin

në gjuhën ruse. Përdorimin e fjalës këngë e gjejmë të ndërfutur edhe në letërsinë shqipe. (Vasil S. Tole)

KËNGËT PËR FËMIJË. Janë para së gjithash për kor pionierësh, por edhe për zë e kor ose zë me shoqërim me piano a orkestrinë. Këngët korale për pionierë kanë rëndësi në edukimin muzikor, sepse ndikojnë në zhvillimin e ndjenjës për shoqërim dhe muzikim. Në moshën e tyre zëri sështë i formuar dhe ambitusi sillet rreth një oktave a decime, krahasuar me zërat e të rriturve. Andaj këndimi është teknikisht me kërkesa më modeste, në përputhshmëri me imagjinatën dhe botëkuptimin fëmijëror. Edhe tekstet përzgjidhen në mënyrë që t'i përshtaten moshës. Këndimi koral te fëmijët/pionierët është 1-zësh dhe 2-zësh. Te pionierët e klasave të larta të shkollës fillore, sidomos tek ata që ndjekin dhe shkollën e ulët të muzikës, ka dhe këngë 3-zësh, e në raste të rralla edhe 4-zësh. Këngë korale dhe sidomos ato për zë solo zakonisht shoqërohen me piano a orkestrinë. Kënga korale për fëmijë/pionierë mund të ketë formë njëpjesëshe, 2 ose 3-pjesëshe, që i përshtaten moshës, psikologjisë, natyrës dhe aftësive. Edhe kompozitorët tanë kanë kompozuar këngë korale për pionierë, si L. Antoni me përmbledhjet “Një gaforre defatore” e “Trumcakët e Kosovës”, S. Gjinali, “Bilbili”, M. Kaçinari, Z. Ballata, M. Piperku, P. Badivuku, N. Krasniqi etj. (Kristina Palokaj-Përkola)

KËNGËT SOLO-ROMANCAT PËR ZË E PIANO. Është gjini muzikore lirike, e kompozuar mbi tekst poetik (apo e përpunuar) nga kompozitorë të ndryshëm, që rëndom shoqërohet me piano, rrallëherë me ndonjë vegël tjetër si lira, kitara, organoja, fizarmonika etj. Sado që si gjini lirike muzikore njihet që në kohët e lashta, ka filluar të kultivohet dukshëm më vonë, sidomos nga kompozitorët e klasicizmit vjenez e këtej, për të vazhduar të jetë gjithnjë e më afërt dhe e pranishme, ku më shumë e ku më pak, pothuaj te të gjithë kompozitorët profesionistë. Ndër kompozitorët shqiptarë këngën lirike/romancën me shoqërim (kryesisht) të pianos, qoftë si këngë të kompozuar lirike mbi tekst artistik apo dhe popullor, qoftë si këngë të përpunuar mbi bazë të këngës popullore e kanë lëvruar kompozitorët në Kosovë dhe në Shqipëri që nga shekulli XIX. Ndër ta janë: P. Kurti, L. Kurti, Th. Nasi, K.

Kono, K. Trako, P. Dingu, T. Daija, Ç. Zadeja, A. Mula, A. Prodani, F. Ibrahim, L. Dizdari, P. Gaci, A. Krajka, N. Zoraqi, F. Deda, V. Gjini, M. Kaçinari, E. Rizvanolli, F. Beqiri, S. Gjinali, Z. Ballata, R. Dhomi, R. Rudi, B. Shehu, M. Mengjiqi, B. Mulliqi e të tjerë. (Zeqirja Ballata)


KËPUSKA Hashim (1939-). Inxhinier i gjeologjisë, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet universitare në Fakultetin e Xehetarisë-Gjeologjisë dhe të Naftës të Universitetit të Zagrebit (1965). Po në këtë fakultet kreu edhe studimet pasuniversitare. Doktoroi në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë të Universitetit të Prishtinës (1998). Në fillim punoi si inxhinier në minierën e kromit “Deva” në Gjakovë dhe më pas në minierën e “Trepçës” në Stantërg (1969-1973) si gjeolog miniere. Në vitin 1969 u zgjodh ligjërues në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë, më vonë kaloi me punë në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë në Mitrovicë (1973) dhe në vitet në vijim mori titujt përkthës universitarë. Në vitin 1975 kreu specializimin njëvjeçar në Akademinë e Minierave në Krakov të Polonisë. Është autor i një teksti universitar, i disa dispensave dhe autor e bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale të botuara në revista vendore dhe ndërkombëtare. Mori pjesë në disa kongrese dhe konferenca shkencore nga lëmi i gjeologjisë brenda dhe jashtë vendit. (Shyqeri Kelmendi)

KËRK-BUNARËT (DYZET PUSËT) E PRIZRENIT. Burime ujore të fuqishme karstike (gurra). Janë rreth 40 burime, në largësi 3 km nga Prizreni, përgjatë luginës së Lumëbardhit. Uji buron në kontaktin e shkëmbinjeve gëlqerorë me shkëmbinjtë joulëshues në tabanin e tyre në sasi mjaft të madhe dhe me një sasi konstante gjatë vitit. Në fillim uji u kaptua me punime ujëmarrëse në Bunarllëkun e poshtëm (415 m lartësi), kurse me vonë uji është kaptuar në katër burime të tjera (1962-1967). Me ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në Prizren (1954), uji me anë të pompimit ngrihej në Kalanë e Prizrenit dhe pastaj me rënie të lirë furnizonte qytetin (60-80 l/sek). Nga të gjitha burimet ujore u siguruan 400-450 l/sek, të cilat furnizonin 98% të qytetit të Prizrenit. (Bashkim Kabashi)

KËRPIMEHI. Fshat në veri të Podujevës, rreth 10 km larg qendrës. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 565 ha. Si vendbanim përmendet në disa dokumente të periudhës osmane. Brenda periudhës 1912-1956 shumë familje emigruan në Turqi e gjetiu. Në vitin 1981 kishte 74 shtëpi me 567 banorë, ndërsa në vitin 1999 kishte 115 familje me 1,140 banorë shqiptarë. Më herët Kërpimehi ishte qendër komunale, në të cilin gravitonin disa fshatra. Sot është seli e bashkësisë lokale. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën fillore dhe të mesme të ulët, qendrën e mjekësisë familjare, disa njësi tregtare dhe objekte shërbyese. (Skender Halimi)

KËRSTIQ Kruno (Krstić) (1905-1987). Leksikograf arbnesh, albanolog, enciklopedist dhe përkthyes. Lindi në Arbnesh të Zarës. Studioi për gjuhë romane, filozofi dhe psikologji në Universitetin e Zagrebit, ku mori doktoratën në psikologji më 1937. U bë i njohur si redaktor i botimeve enciklopedike. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte redaktor në Institutin Leksikografik të Zagrebit. Ishte ndër themeluesit e lëvizjes shoqërore për gjuhën standarde kroate dhe përkrahu krijimin e drejtshkrimit, të gramatikës, të fjalorëve të gjuhës së përgjithshme dhe të fjalorëve terminologjikë etj. Me gjuhëtarin P. Guberina botoi veprën “Dallimet ndërmjet gjuhës standarde kroate dhe serbe” (Zagreb, 1940). Studioi të folmen e banorëve arbneshë dhe hartoi “Fjalorin e të folmes së arbneshëve të Zarës” (1987). Sipas tij, emigrantët arbneshë në Zemunik dhe Plloçe shumë shpejt u kroatizuan, ndërsa vendbanimi Arbanasi e ruajti deri më sot gjuhën shqipe-arbënisht. (Hana Radoniqi)

KËRVESHI Muhamet (1935-). Lindi në Mitrovicë. Kreu shkollën fillore në Pejë, gjimnazin në Mitrovicë, ndërsa studimet universitare për gjuhë e letërsi frënge në Universitetin e Beogradit. Mbaroi studimet pa-suniversitare në Zagreb. U doktorua në Prishtinë. Punoi si mësimdhënës i gjuhës frënge në shkollën e mesme të Mitrovicës dhe të Pejës, ndërsa nga viti 1972 filloi punë si profesor i gjuhës frënge në Fakultetin Filozofik



MUHAMET
KËRVESHI

të Universitetit të Prishtinës. Shkruan për të rritur dhe për fëmijë. Vjershën e parë për fëmijë e botoi në revistën “Pionieri” më 1949, ndërsa për të rritur më 1955 në “Jeta e re”. Botoi mbi 20 vëllime poetike origjinale dhe një sërë veprash të përkthyer. Poezitë e tij janë paraqitur në shumë panorama e antologji të poezisë shqipe, të botuara në Kosovë, Shqipëri dhe vende të ndryshme të botës, ndër të cilat “Antologjia e lirikës shqipe” në italisht, përgatitur e botuar nga Ernest Koliqi (Milano, 1963). M. Kërveshi është përkthyes i mbi 10 veprave letrare të poetëve më të shquar francezë, nga të cilët veçohen Bodler dhe Apoliner, si dhe ka përkthyer nga serbo-kroatishtja dhe turqishtja. Është autor edhe i disa librave për fëmijë. Përveç poezive shkroi tregime, drama, kritikë dhe eseistikë. Ndër veprat e tij kryesore janë: “Ngjyrat e dashurisë” (1964), “Portretet në miniaturë” (1966), “Hijet” (1968), “Valët e reja” (1971), “Rrathët” (1973), “Piramidat” (1976), “Ura” (1978), “Kundruall” (1980), “Vazhdimësi” (1982), “Sheshi i ditës” (1985), “Lojë në vazhdimë” (1985), “Syri i Kosovës” (1993), “Shirat flasin” (1997), “Jetë guri” (2003), “Zjarri i përqaftuar” (2004), “Zilja e kujtimeve” (2004), “Kopshtari i dashurisë” (2003), “Prania e padukshme”, pastaj përmbledhen me tregime “Në pasqyrë” dhe librin me kritikë letrare “Kontaktet letrare” (1999), dramën “Rrobat e sundimtarit” dhe monodramën “Çelësi” (2005). Botoi edhe disa vepra për fëmijë: “Telegrame të dallëndysheve” (1972), “Ylli rojtar” (1981), “Fjalë e nënës zog” (1986), “Shtëpia e re” (1989), “Ura” (1997), “Xhufi” (2001) etj. M. Kërveshi është fitues i çmimeve letrare dhe mirënjohjeve të tjera. (Femi Cakolli)

KËRZHIQ (Kržić) Miomir (1928-2014). Mjek, dermatovenerolog, profesor universitar. Lindi në fshatin Moshnice, komuna e Beranes (Mali i Zi). Shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në vendlindje dhe Berane. Në vitin 1951 ishte i burgosur politik në Goli Otok. Studimet e larta i vazhdoi dhe i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Beogradit (1956). U specializua në lëmin e dermatovenerologjisë në vitin 1963 në Klinikën e Dermatovenerologjisë të Universitetit të Zagrebit. U punësua në repartin e dermatovenerologjisë në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, si mjek i lëkurës. Në vitin 1974 u themelua Klinika e Dermatovenerologjisë e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe u emërua drejtor i kësaj

klinike. U emërua ligjërues dhe docent i lëndës së dermatologjisë. Mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës në Universitetin e Beogradit (1974). Në vitet vijuese i arrin të gjithë titujt akademikë dhe njëkohësisht mbajti pozitën e drejtorit të Klinikës së Lëkurës. Botoi një varg punimesh shkencore dhe profesionale brenda dhe jashtë vendit. (Afërdita Daka)

KËSHILLAT NACIONALÇLIRIMTARE NË KOSOVË. Organe të pushtetit popullor të formuara gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (LNÇ), nën përkujdesjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Këshillat Nacionalçlirimtare (KNÇ) në Kosovë filluan të formohen me direktivë të Komitetit Krahinor të Kosovës (25 maj1942), të mbështetur në vendimin e 31 janarit 1941. Qëllimi kryesor i tyre ishte përhapja, ndihma dhe propagandimi i LNÇ-së si dhe vendosja e një rrjeti organizativ e politik në territorin e Kosovës. Si organe politike ato shërbenin për tubimin e anëtarëve dhe simpatizantëve të rinj rreth programit të PKJ-së për rekrutimin e partizanëve, strehim të pjesëtarëve të njësiteve partizane, të funksionarëve dhe anëtarëve të partisë. Këshillat u themeluan së pari në fshatrat serbe, posaçërisht në rrethinën e Ferizajt, më pas të Prishtinës dhe të Gjilanit. Në verën e vitit 1942 këshillat u formuan edhe në Prizren dhe në Gjakovë, ku njëri përbëhej nga serbët dhe një tjetër nga shqiptarët. Në Pejë këshilli i parë u formua në Vitomiricë, nga malazezët dhe po në atë periudhë u themelua edhe në Mitrovicë. Në vitin 1943 kishte të organizuar rreth 30 këshilla me mbi 160 anëtarë, numër ky që u rrit dukshëm pas kapitullimit të Italisë. Me zgjerimin e LNÇ-së, në nëntor të vitit 1943 u mor vendimi për formimin e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Metohisë (Dukagjinit). Konferenca për themelimin e këtij organi të pushtetit vendor u mbajt më 31 dhjetor 1943 dhe 1-2 janar 1944 në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Këshilli Krahinor Nacionalçlirimtar ishte bërthamë e organizuar e pushtetit, i cili u aktivizua veçmas pas tërheqjes së trupave gjermane. Si organe të pushtetit funksionuan deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. (Mrika Limani)

KËSHILLI I MEDIAVE TË SHKRUARA TË KOSOVËS (KMSHK). Trup vetërregullues i formuar nga sektori i medieve të shkruara. U

themelua në shtator të vitit 2005, i përkrahur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE) në Kosovë. Fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht dhe me kohë, si dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë, janë baza mbi të cilën vepron KMSHK-ja. Qëllimi i Këshillit është ta mbrojë qytetarin nga shkrimet e pavërteta si dhe ta mbrojë gazetarin nga ankesat e pambështetura. Këshillin e përbëjnë kryeredaktorët e gazetave, të revistave dhe të portaleve dhe të agjencive të lajmeve. Ai ka tre anëtarë të pavarur, kryetarin dhe dy nënkryetarët. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e gazetave, portaleve dhe të agjencive të lajmeve. Kryetarë të deritashëm të Këshillit ishin: Xhemajl Rexhepi, Ibrahim Berisha dhe Imer Mushkolaj. Nehat Islami është drejtor i zyrës së Këshillit. KMSHK-ja, ndër të tjera, ka për qëllim fuqizimin dhe respektimin e kodit të medieve të shkruara në Kosovë, edukimin e brezave të rinj të gazetarëve dhe studentëve të gazetarisë, lidhur me të drejtën e qytetarëve për t'u informuar drejt dhe me kohë. (Artan Krasniqi)

KËSHILLI KOORDINUES I PARTIVE POLITIKE TË SHQIPTARËVE NË ISH-JUGOSLLAVI. Platformë ndërpartiake e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës u përkeqësua edhe pozita e shqiptarëve në viset e tjera të ish-Jugosllavisë. Popullsia shqiptare e Kosovës, e Maqedonisë, e Luginës së Preshevës dhe e Malit të Zi, që së bashku përbënin kombin e tretë për nga numri në ish-Jugosllavi, u gjetën pa një drejtim politik. Me qëllim të artikullimit më të qartë të kërkesave politike, për të avancuar statusin e tyre në prag të shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave, partitë politike të posaformura shqiptare më 11 tetor 1991 themeluan Këshillin Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, me kryetar dr. Ibrahim Rugovën. Këshillin e përbënin njëmbëdhjetë parti politike shqiptare: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia e Prosperitetit Demokratik, Lidhja Demokratike e Malit të Zi, Partia për Veprim Demokratik (Lugina e Preshevës), Partia Fshatare e Kosovës, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Socialdemokrate e Kosovës, Partia e Unitetit Kombëtar Shqiptar, Partia Popullore Shqiptare dhe Partia Demokratike Shqiptare. Në situatën e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe në

bazë të së drejtës së popujve për vetëvendosje, Këshilli Ndërpartiak i Partive Politike Shqiptare u përcaktua për këto tri variante të mundshme të zgjidhjes së çështjes shqiptare: 1) Nëse nuk ndryshohen kufijtë e jashtëm as të brendshëm të Jugosllavisë, Kosovës duhet t'i njihet statusi i republikës, ndërsa shqiptarëve të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Luginës së Preshevës t'u njihet statusi i popullit shtetëformues; 2) Nëse kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë nuk ndryshojnë, por ndryshojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet republikave, atëherë duhet të krijohet Republika Shqiptare e Jugosllavisë; 3) Nëse ndryshojnë kufijtë e jashtëm të Jugosllavisë, atëherë populli shqiptar në Jugosllavi, përmes deklaratimit të përgjithshëm me plebisht, do të vendosë të bashkohet me Shqipërinë dhe të krijojnë shtetin shqiptar në Ballkan në kufijtë e tij etnik. (Ismet Salihu)

KËSHILLI NACIONALÇLIRIMTAR PËR KOSOVË E RRAFSH TË DUKAGJINIT (1943-1944). Organe të pushtetit komunist gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe mënjëherë pas saj. Në dhjetor të vitit 1942, Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste (PKJ) të Jugosllavisë u dha detyrë komunistëve të Kosovës që të formonin këshillat nacionalçlirimtare, si organe të pushtetit vendor. Në nëntor të vitit 1943, në një mbledhje të Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë u mor vendimi për formimin e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar. Këshilli thirri një konferencë të gjerë, me qëllim që të themelohet këshilli nacionalçlirimtar i përbashkët për të gjithë Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit. Konferenca u mbajt në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Këshilli Nacionalçlirimtar për Kosovë e Dukagjin (Metohi) përfaqësonte organin e luftës së popullit dhe embrionin e pushtetit të ardhshëm popullor. Nga fundi i vitit 1943 dhe në fillim të vitit 1944 u zgjerua rrjeti i këshillave nacionalçlirimtare gjithandëj ku ekzistonin organizatat e Partisë, përfshirë edhe disa fshatra shqiptare, ku nuk kishte komunistë. Deri në fund të luftës, Këshilli Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit e zgjeroi rrjetin e vet në tërë Kosovën. (Daut Bislimi)

KËSHILLI NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE (KNGJSH). Këshill i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe

të Arteve të Kosovës, që shqyrton çështjet që lidhen me përdorimin dhe zhvillimin e shqipes standarde. U themelua më 2004 dhe fillimisht përbëhej nga 17 anëtarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe diaspora arbëreshe, të cilët përfaqësojnë institucione të ndryshme që merren me studimin e shqipes: Shaban Demiraj e Rexhep Ismajli (bashkëkryetarë), Besim Bokshi, Emil Lafe (bashkësekretarë), Idriz Ajeti, Remzi Nesimi, Francesk Altimari, Jani Thomai, Gjovalin Shkurtaç, Seit Mansaku, Mehmet Çeliku, Enver Hysa, Tomor Osmani, Fadil Raka, Isa Bajçinca, Shefkije Islamaj, Imri Badallaj dhe Abdullah Zymberi. Më 2010 ky Këshill u plotësua me 5 anëtarë të rinj: akademikët Kolec Topalli, Ethem Likaj dhe profesorët Shezai Rrokaj, Bardh Rugova dhe më pas edhe Rrahman Paçarizi (zëvendësoi të ndjerin Fadil Raka). Ndërkohë janë inkuadruar edhe Mehmet Halimi, Shkumbin Munishi dhe Asllan Hamiti (në vend të Remzi Nesimit). Këshilli ka një përfaqësim të gjerë. Në të janë përfshirë institucionet shkencore që merren me studimin e gjuhës shqipe, duke filluar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Tiranës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, i Elbasanit, i Shkodrës, i Prizrenit dhe i Kozencës. Nga viti 2011 kryesohet nga R. Ismajli e J. Thomai. Ndërkohë Këshillit i janë bashkuar M. Halimi dhe N. Caka. Këshilli përbëhet nga grupet punuese për fusha përkatëse të gjuhësisë. Këshilli ka hartuar dhe aprovuar rregulloren e punës. Më 26 maj 2005 u mbajt mbledhja e Këshillit Ndërkademik për Gjuhën Shqipe, pjesa e Kosovës, me ç'rast janë propozuar komisionet studimore: për çështjet e drejtshkrimit (Fadil Raka, Flutura Çitaku, Shkumbin Munishi); transkriptimi i fjalëve nga gjuhët e huaja (Vesël Nuhiu, Idriz Ajeti dhe Nebih Caka), probleme të normës morfologjike (Besim Bokshi, Ragip Mulaku, Rrahman Paçarizi), probleme të normës sintaksore dhe të pikësimit (Isa Bajçinca, Sala Ahmetaj, Linditë Rugova dhe Hasan Mujaj), probleme të leksikut e të normës leksikore (Shefkije Islamaj, Bardh Rugova, Abdullah Zymberi, Qemal Murati), probleme të formimit gjuhësor në shkollë (Imri Badallaj, Zijadin Munishi). Më 3 qershor 2005 u mbajt në Tiranë mbledhja e Këshillit Ndërkademik në përbërje të plotë,

në të cilën u vendos formimi i komisioneve hulumtuese si më lart me propozime edhe të anëtarëve të komisioneve nga pala e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Takimi i dytë i Këshillit është mbajtur gjithashtu në Tiranë më 19 nëntor 2005. Në të pala e Kosovës ka sjellë raportet e grupeve të punës për çështje të drejtshkrimit, për leksik dhe terminologji, për fjalë të huaja, derisa delegacioni nga Shqipëria një raport për çështje të drejtshkrimit. Mbledhjet janë rikthyer pas vitit 2010 me nga dy takime në vit (dy në Shqipëri dhe dy në Kosovë). (Bahri Koskoviku)

KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVË TË NJERIUT (KMDL NJ).

Organizata e parë joqeveritare për të drejtat e njeriut në Kosovë. U themelua nga një grup veprimtarësh më 14 dhjetor 1989 në Prishtinë. Gjatë viteve '90 zhvilloi një aktivitet të gjerë në evidencimin dhe denoncimin e shkeljes së të drejtave të njeriut në periudhën e represionit serb në Kosovë. Këshilli kishte një rrejt të gjerë bashkëpunëtorësh të organizuara nëpër degë në të gjitha komunat e Kosovës. Për shkak të aktivitetit në terren, bashkëpunëtorët, aktivistët dhe anëtarët e Këshillit, gjatë viteve '90 dhe në periudhën e luftës 1998-1999 u gjendën në shënjestër të organeve të policisë serbe, duke u keqtrajtuar, burgosur madje edhe duke u vrarë disa prej tyre.

Kryetar i parë i KMDL NJ-së ishte Adem Demaçi, reputacioni i të cilit si ish-i burgosur politik me kohëzgjatje më të madhe në ish-Jugosllavi ushtroi ndikim pozitiv në punën e Këshillit. KMDL NJ-ja që herët u bë anëtar i Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (FIDH) me seli në Paris dhe anëtar i Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut. Këshilli bashkëpunoi me Tribunalin e Hagës, ku së pari deponoi padi për krimet e Slllobodan Milosheviqit në Kosovë dhe më pas dorëzoi fletëdenoncime penale kundër udhëheqësve jugosllavë të dyshuar për krime lufte. Ndër prioritetet e Këshillit ka qenë dhe vazhdon të jetë ndriçimi i fatit të personave të zhdukur. Merret edhe me edukimin për të drejtat e njeriut, duke organizuar trajnime nga kjo fushë për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe të Policisë së Kosovës. KMDL NJ po ashtu monitoron zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme, si dhe proceset gjyqësore, qendrat e ndalimit, të parburgimit,

burgjet hetuese dhe shtëpitë korrektuese, si dhe merret me aktivitete të tjera të kësaj fushe. Bashkëpunon me shumë OJQ nga fusha e të drejtave të njeriut, me komisione, si anëtar i shumë rrjeteve dhe federatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Përveç publikimeve periodike të informatave dhe raporteve në formë komunikatash apo të konferencave për shtyp, KMDL NJ ka botuar edhe raporte përmbledhëse, pastaj përmbledhje komunikatash, të konferencave për shtyp etj. Ka botuar edhe doracakë të ndryshëm për edukimin e brezave të rinj në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe vëllimin e parë të përmbledhjes së dëshmimeve të krimeve të luftës të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, dosjet "Çështja Dita", "Të drejtat e pakicave" etj. (Haki Kasumi)

KËSHILLI QENDROR I FINANCIMIT (1992-1999).

Organizëm për grumbullimin e mjeteve financiare për financimin e arsimit shqip në Kosovë, në vitet 1992-1999, në rrethanat e vendosjes së administratës së jashtëzakonshme serbe. Në fillim të vitit 1991, arsimit shqip në Kosovë iu ndërpre financimi, mësimdhënësit shqiptarë mbetën pa të ardhura personale. Ndaj, në vitin 1992, u formua Këshilli Qendror i Financimit i Kosovës, i cili mori përsipër financimin e punonjësve të arsimit shqip. Këshilli përbëhej prej nëntë anëtarësh, përfaqësues të partive politike dhe të institucioneve të arsimit. U formuan, gjithashtu, edhe këshillat komunale të financimit dhe mekanizmat për grumbullimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare. Mekanizma të ngjashëm u formuan edhe në diasporë. Këshilli miratoi rregulloren për shpërndarjen e mjeteve financiare të grumbulluara. Financimi i rregullt i punonjësve të arsimit shqip nga ky këshill në Kosovë filloi më 1 prill 1992. Pagat e mësimdhënësve ishin minimale, ndonëse ato u rritën nga viti në vit. Pagat më të mëdha i kishin mësimdhënësit universitarë, ngase krijonin të hyra financiare nga pagesat e studentëve. Gjatë këtij procesi u paraqitën edhe vështirësi. Gjatë viteve 1992-1998, janë financuar rreth 20,000 punonjës të arsimit shqip në Kosovë, në të gjitha nivelet. 60% e mjeteve financiare për arsim janë grumbulluar në Kosovë, ndërsa rreth 40% të tyre Këshilli i ka marrë nga Qeveria e Kosovës në mërgim, të grumbulluara nga diaspora kosovare. (Bajram Shatri)

KËSHILLI SHTETËTOR PËR LICENCI-MIN E MËSIMDHËNËSVE (KSHLM). Organ profesional këshillëdhënës, i mandatuar nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), sipas Ligjit për arsimin parauniversitar (2011), i cili është përgjegjës për zbatimin e procesit të licencimit të mësimdhënësve dhe të politikave përkatëse për zhvillimin, avancimin dhe kualifikimin e mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim. Licencimi ka të bëjë me lejimin për ushtrimin e punës së mësimdhënësit dhe të detyrave të tjera në shkollë. KSHLM-ja mund të ketë edhe përgjegjësi të tjera, të deleguara nga MASHT-i, si: zhvillimi profesional i obliguar për të gjithë mësimdhënësit, standardet e performancës së mësimdhënësve, profili i kompetencave të mësimdhënësve, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve etj. (Naser Zabeli)

KËSHILLIMORET E FËMIJËS. Institucione shëndetësore parandaluese, që ofrojnë shërbime cilësore për mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve nga sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet. Janë të pajisura me të gjitha mjetet për përcjelljen e zhvillimit antropometrik të fëmijët, duke u bazuar në tabelat e zhvillimit fizik dhe mendor. Këshillimi bëhet kryesisht mbi rëndësinë e ushqimit me gjë gjatë muajve të parë të jetës, përgatitjen e ushqimit plotësues, higjienën personale, përcjelljen e daljes së dhëmbëve si dhe vaksinimin dhe rivaksinimin e rregullt, sipas kalendarit të vaksinimit (PZI). Bëhen vizitat e vazhdueshme të rritës dhe zhvillimit të fëmijëve, si dhe këshillimet e nënave për zhvillimin e foshnjave. Në vitin 1940 në Kosovë kanë qenë 6 këshillimore për fëmijë, ndërsa në vitet 2000-2001 funksionimi i tyre u arrit në çdo shtëpi të shëndetit në qytetet e mëdha. Sot këto shërbime ndodhen në të gjitha qendrat kryesore të mjekësisë familjare. (Drita Salihu-Zajmi)

KËSHILLIMORET E GRUAS SHTATZËNË. Institucione shëndetësore parandaluese, që u ofrojnë shërbime shtatzënave prej fillimit të shtatzënisë e deri në periudhën e lindjes dhe të lehonisë. Shtatzënia përcillet në mënyrë sistematike dhe periodike nga punëtori shëndetësor, i cili njëkohësisht ofron edhe këshilla për zhvillimin e një shtatzënie të shëndetshme. Këshillat kryesisht kanë të bëjnë me konsumimin e ushqimit të shëndetshëm,

aktivitetin fizik, pushimin dhe rekreacionin si dhe evitimin e dukurive negative gjatë shtatzënisë. Detyrë tjetër kryesore e punëtorëve shëndetësorë në këto këshillimore është edhe përgatitja e shtatzënave për lindje dhe gjidhënie. Në vitin 1954 kanë qenë gjithsej 15 këshillimore për shtatzëna në Kosovë, gjatë viteve '70 kanë qenë 13, ndërsa gjatë viteve 2000-2001 u arrit që çdo shtëpi e shëndetit në qytetet e mëdha të Kosovës të ketë nga një këshillimore për shtatzëna. (Drita Salihu-Zajmi)

KËSHTJELLA E ZVEÇANIT. Kështjellë mbi një kodër vullkanike në veri të Mitrovicës (797 m). Lumi Ibër i sillet rreth e përçark kodrës, duke filluar nga jugperëndimi, pastaj nga lindja



KËSHTJELLA E ZVEÇANIT

dhe veriu. Rrënojat dhe themelet e kështjellës së Zveçanit janë të kohës ilire. Fortifikata e Zveçanit është e njohur sipas burimeve bizantine të shek. IX - X. Me këtë emër për herë të parë e ndeshim në vitet 1091-1093 nga kronistët bizantinë, të cilët i përshkruanin luftërat e zhupanit të Rashës, Vukanit, me mbretin bizantin, Aleksin I Komneni. Kodra konike e Zveçanit, nga ana lindore, është e mbrojtur nga shkëmbinj natyrorë. Nga ana veriore dhe perëndimore mali është i pyllëzuar me shkurre të ulëta. Në lindje shtrihet Rrafshi i Kosovës, nëpër të cilin zgjatet lumi Sitnica, kurse në fund të kodrës, rrëzë malit, në një fushë aluvionale takohen dy lumenjtë: Ibri dhe Sitnica, aty ku është ngritur qyteti i Mitrovicës. Kështjellën e Zveçanit e gjejmë edhe në literaturën e udhëpërshkruesve. Duke përshkruar udhëtimin e tij në lindje, më 1573, Philippe du Fresne-Canaye përmend Zveçanin si kështjellë të vjetër. Më 1582, Jean Palerne Foresien, gjatë udhëtimit prej Sofjes

deri në Raguzë, kishte kaluar pranë Zveçanit, për të cilin thotë se është kështjellë e Mihail Komnenit. Evlia Çelebiu vë në dukje kështjellën e Zveçanit në formë vezake, prej guri dhe thotë se ka vetëm një portë. Kështjella e Zveçanit është mbajtur mirë deri në fillim të shek. XIX, kur udhëpërshkruesi Pukvil e quante “qyteti i madh dhe i vjetër”, kurse tani, thotë ai, është rrënuar. Udhëpërshkruesit e shek. XIX e përshkruajnë Zveçanin si një fortifikatë të braktisur e të rrënuar, por brenda mureve të qytetit kanë hasur në mbetje të ndërtesave të lashta. Ami Boue më 1840 kishte parë mbetjet e kishës, ndërsa më 1857 Aleksander Hilferdingu e quan pallat mbretëror. (Pajazit Hajzeri)

KFOR-i. Forcë paqeruajtëse e udhëhequr nga Aleanca Veriatlantike (NATO) në Kosovë. U themelua me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të



USHTARË TË KFOR-IT

miratuar më 10 qershor 1999. Trupat e KFOR-it hynë në Kosovë më 12 qershor 1999, dy ditë pas miratimit të rezolutës 1244. Përgjegjësia parësore e KFOR-it ishte krijimi i një mjedisi të sigurt në Kosovë. Fillimisht, KFOR-i kishte rreth 50 mijë trupa, që vinin nga 39 shtete të ndryshme, anëtare të NATO-s dhe disa që nuk ishin anëtare të NATO-s. Kjo prani ushtarake në Kosovë është reduktuar gradualisht. Në shtator të vitit 2014 KFOR-i numëronte 4 mijë trupa nga 31 shtete kontribuese. Misioni i KFOR-it gjithashtu pësoi ndryshime pas shpalljes së

pavarësisë së Kosovës, duke u përqendruar në krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe të një strukture civile që do të mbikëqyrte FSK-në. (Qerim Qerimi).

KIÇE Salajdin (1951-). Është njëri nga pionierët e trupës së baletit në Teatrin Popullor Krahinor (TPK). Në vitin 1979 përfundoi shkollën e baletit “Jordan Misja” në Tiranë. Që nga vitit 1972, si anëtar i trupës së baletit në TPK, realizoi disa role në shfaqje të ndryshme baleti. Ndër realizimet e tij më të suksesshme është roli i Korrierit në baletin “Legjenda mbi ngadhënjimin” të kompozitorit Rexho Mulliqit (1981). Interpretoi edhe në shfaqjet e baletit: “Halili dhe Hajria” nga Tish Daija (1979), “Era dhe Kolona” nga A. Koci (1983) dhe “Kënga e Rexhës” po nga A. Koci (1983) etj. Njihet si njëri ndër pionierët e Trupës së Baletit në TPK. (Arian Krasniqi)

KIÇINA Rrahman Rasim (1972-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Baincë të Drenasit. Kreu shkollën fillore në fshatin e lindjes, gjimnazin në Drenas. Ishte student në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës. Në fillim të viteve ‘90 mbajti kontakte me veprimtarët e Lëvizjes Popullore të Kosovës. U përfshi në radhët e grupeve që kryenin aksione të armatosura kundër policisë serbe. Me rastin e rrethimit të dytë të kullës së Jasharajve në Prekaz, më 22 janar 1998, R. Kiçina ndodhej së bashku me M. Jasharin, i cili ishte i plagosur. Më 28 shkurt së bashku me luftëtarë të tjerë të UÇK-së mori pjesë në betejën që u zhvillua në Likoshan. Në pranverë të vitit 1998, me bashkëluftëtarët e tij themeloi kazermën lokale ushtarake në Baicë, ku stërviteshin luftëtarët e UÇK-së. Ishte ndër themeluesit e njësitit luftarak “Alfa”. Mori pjesë në dhjetëra aksione dhe në shumë beteja të UÇK-së, si në Kijevë, në grykën e Llapushnikut etj. R. Kiçina bënte pjesë në rrethin e ngushtë të eporëve të Shtabit të Përgjithshëm. Më 30 maj të vitit 1999 ra në pritë të forcave armike në dalje të Negrocit, në rrugën drejt Arllatit, ku dhe u vra. Në vitin 2009 presidenti i Kosovës i ndau Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Sylë Ukshini)

KIÇMARI Sabri (1967-). Veprimtar politik, diplomat. Lindi në Lladofc të komunës së Podujevës. Kreu studimet për shkencat politike

në Universitetin e Bonit në Gjermani, ku më pas kreu studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e doktoratës (2007). Veprimi në ilegalitet në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Nga marsi deri në gusht të vitit 1989 qëndroi në ilegalitet bashkë me një grup shokësh, që atëbotë njiheshin si “Çeta e Llapit” dhe më vonë kaloi ilegalisht në Gjermani, ku vazhdoi veprimtarinë në kuadër të Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në shkurt të vitit 1997 u angazhua për të ndihmuar organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Llap. Në tetor të vitit 1998 Drejtoria Politike e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e emëroi përfaqësues për marrëdhënie me jashtë të UÇK-së. Në vitin 1999 qëndroi në Rambuje, si mbështetje politike e delegacionit të Kosovës. Nga viti 2009 shërbeu si ambasador i Republikës së Kosovës në Austri, kurse nga viti 2013 ambasador në Australi. Ka botuar librat: “Drejtpeshimi”, “Individi dhe shoqëria në Kosovë” (2009) dhe librin në gjuhën gjermane “Republika e Kosovës, krijimi i shtetit dhe struktura sociale”. (Ismet Cakiqi)

KIJEVA. Fshat në trevën e Llapushës, në komunën e Malishevës, 12 km në veriperëndim të saj. Shtrihet në lartësi mesatare mbidetare 572 m dhe është vendbanim i tipit të shpërndarë. Përbëhet nga këto lagje: Toplanaj, Gash, Bacali, Berishë, Ngucataj dhe Kurosh. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1831.9 ha, nga e cila 65% janë pyje, 25% ara dhe 10% livadhe. Si vendbanim përmendet në disa dokumente mesjetare. Në defterin kadastral turk (1455) përmendet si vendbanim me 17 shtëpi, ndërsa në një hartë ushtarake (1689) është regjistruar me emrin Kievo. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave e kishte statusin e qendrës komunale. Në vitin 2011 Kijeva kishte 1,279 banorë, ndaj 779 banorëve në vitin 1948. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe tregti. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, shkollë të mesme, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare, shtëpinë e kulturës, postën, bibliotekën etj. (Ferim Gashi)

KIKAJ Vehbi (1942-1986). Shkrimtar për fëmijë. Lindi në fshatin Lupç i Poshtëm të Podujevës. Kreu shkollën fillore në fshatin Besi, ndërkaq Shkollën Normale në Prishtinë. Ndoqi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punoi si



VEHBI KIKAJ

redaktor në “Rilindjen për fëmijë” dhe redaktor dhe kryeredaktor shumëvjeçar i revistës “Pionieri”. Vdekja e gjeti në pozitën e kryeredaktorit të revistës letrare “Fjala”. Është njëri ndër përfaqësuesit kryesorë të shprehjes moderne në letërsinë shqipe për fëmijë. Shkroi poezi, tregime dhe një roman për fëmijë. Botoi librat për fëmijë “Gurra” (1963), “Zogu i argjendtë” (1964), “Sarajet e bardha” (1968) dhe “Shtëpia ime ka sy” (1972). Nga libri në libër avancoi shprehjen letrare dhe pasuroi temat e motivet. Në kompletin e veprave, që iu botua pas vdekjes, u përfshinë edhe poezitë e tij më të reja në ciklin “Lumit i kthehet lejleku”. Poezia e tij u përfshi në të gjitha panoramat dhe antologjitë e letërsisë shqipe që u botuan në Prishtinë dhe në Tiranë, po edhe në gjuhë të tjera. Poezia e tij, e sidomos romani “Sarajet e bardha” u përkthye edhe në gjuhë të tjera dhe u bë lekturë e obligueshme shkollore për nxënësit me mësim në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi. (Xhevat Sylja)

KIKI Afërdita (1971-). Piktore. Lindi në Lörrach (Gjermani). Kreu studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës. Hapi disa ekspozita personale, si në Qendrën Informativ Kulturore në Shkup, në Galerinë “Vangel Koxhoman” në Strugë, në Qendrën Kulturore Franceze në Shkup, në Qendrën Kulturore të Maqedonisë në Nju-Jork, në Galerinë Kombëtare të Maqedonisë, në Galerinë e Arteve në Tetovë, në Qendrën Informativ Kulturore në Sofje, në “Cite Internationale des Arts” në Paris etj. Është fituese e çmimit për krijimtari nga organizata “Polio Plus”. Veprat e saj janë autentike, të mbushura me gjallëri lirike dhe sintezë ndërmjet të sotmes dhe tradicionales. Është autore e scenografive të disa shfaqjeve në Teatrin Shqiptar në Shkup, në filmin “Mbrapa errësirës”, si edhe në shfaqjen e baletit të Iskra Shukarovës në Paris. Jeton dhe krijon në Shkup. (Jëlldeze Asani)

KILAJ Isni (1963-). Veprimtar politik, pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Lubizhdë të Malishevës. Mbaroi studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (1987). Ishte

themelues i degës së LDK-së për Komunën e Malishevës dhe themelues i shtabit të mbrojtjes të organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në bashkëpunim me Sokol Bashotën dhe Gani Krasniqin formuan celulatat e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për rajonin e Llapushës (1996). Më 1997 u themelua Nënzona Operative “Lumi”, komandant i së cilës u emërua I. Kilaj. Në bashkëpunim me njësitin “Arti” nga Rahoveci dhe njësitet nga Theranda filloi sulmi për marrjen e Rahovecit (22 korrik 1998). Pas katër ditë rezistence, I. Kilaj dhe njësitit i tij e lëshuan Malishevën (28 korrik) dhe pikat që mbanin më parë. Më pas ishte edhe zëvendëskomandant i Zonës Operative të Pashtrikut (tetor 1998). Pas përfundimit të luftës ka kryer detyra me përgjegjësi në komunën e Malishevës. Ishte kryetar i komunës së Malishevës për dy mandate (2007-2013). (Skënder Lutfiu)

KIRBI Grin (Green William Kirby) (1836-1891). Diplomati britanik që shërbeu si konsull në Shkodër, gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në Nauplia, Greqi. Hyri në shërbimin konsullor që në moshë të re, në vitin 1856, fillimisht në Egjipt, më vonë në Marok, Tunizi dhe në Damask. Në vitin 1876 emërohet konsull në Shkodër dhe në vitin 1879 konsull i përgjithshëm për Malin e Zi dhe vilajetin e Shkodrës, ku qëndroi deri në vitin 1886. Më vonë emërohet përsëri në Marok. Gjatë punës së tij si konsull në Shkodër, G. Kirbi në raportimet e tij shfaq njëanshmëri dhe subjektivizëm në vlerësimin e zhvillimeve politike në Shqipëri dhe në konsideratat e tij për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Sipas tij, Lidhja e Prizrenit ishte vegël e Perandorisë Osmane dhe e akuzon këtë të fundit se nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë për shtypjen e saj. Vlerësimet e konsullit Grin nuk përputhen me ato të ambasadorit britanik në Stamboll, Goshen, i cili shpesh shprehte pakënaqësi me raportet e tij tendencioze. G. Kirbi qëndron në zanafillë të propozimit anglez (dhe austro-hungarez) për t’ia dorëzuar Malit të Zi Ulqinin me rrethinë. (Islam Lauka)

KISERI Nehat (1939-1987). Mjek, stomatolog, profesor universitar. Lindi në Prizren. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në qytetin e lindjes, u diplomua në Fakultetin e Stomatologjisë në Beograd (1964). Pas

diplomimit punoi si stomatolog në Prizren. Specializimin për sëmundjet e gojës dhe të dhëmbëve i përfundoi në Beograd (1973), ndërsa më 1979 kaloi me punë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, në seksionin e stomatologjisë. Studimet pasuniversitare i kreu në Beograd (1977), ndërsa tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Stomatologjisë në Sarajevë (1980). Fillimisht u zgjodh asistent, më pas u avancua në titullin docent dhe profesor inordinar për lëndën sëmundjet e gojës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Kreu funksione dhe detyra në institucionet shëndetësore dhe arsimore të Kosovës. (Fatmir Dragidella)

KISHA BIZANTINE. Kishë e lidhur me emrin dhe funksionimin e Perandorisë Bizantine (313-1453). Kisha bizantine-ortodokse zuri fill nga fundi i shek. IV, kur Perandoria Romake u nda në Perandorinë Romake të Perëndimit me qendër në Romë dhe Perandorinë Bizantine me qendër në Konstandinopojë. Ndarja politike pati reflektime edhe në sferën fetare, por u deshën rreth shtatë shekuj që kisha bizantine të pavarësohet dhe të ndahet plotësisht nga Roma (1054). Organizimi kishtar në Ilirikun Lindor, ku do të shtrihet me vonë kisha bizantine, u krijua gradualisht, duke i përballuar përndjekjet e perandorëve të Romës, që nga Neroni deri te Diokleciani. Deri në fillimin e shek. IV në territorin ku do të shtrihet Perandoria Bizantine ishin krijuar organizime funksionale të krishtera, që arrinin në nivelin e ipeshkvijve. Lidhur me funksionimin e këtyre ipeshkvijve dëshmojnë të dhënat kishtarë, që dalin nga Konkili i Nikesë (325). Këtu ishin të pranishëm disa ipeshkvij të Dardanisë dhe të Maqedonisë. Organizimi kishtar i krijuar në territorin e ardhshëm të Bizantit pas Ediktit të Milanos (313) u shkatërrua disa herë gjatë sulmeve të popujve barbarë: hunëve, avarëve, sllavëve etj. Megjithatë, aktiviteti i etërve të krishterë vazhdoi edhe në këto kushte. Ipeshkvi, Niketë Dardani, nga Remesiana (sot Bela Palanka në Serbi), i cili vdiq në vitin 414, u bë autori i himnit më të njohur kishtar “Te Deum Laudamus” (Ty Zot të lavdërojmë). Shën Jeronimi ishte një figurë tjetër e krishterimit të hershëm në Iliri (vdiq në vitin 420), që përktheu “Dhiatën e Vjetër” nga hebraishtja në latinisht dhe “Dhiatën e Re” nga greqishtja në latinisht, duke i ofruar Europës versionin e parë

të plotë të Biblës në latinisht. Mbi këto baza kulturore, fetare dhe politike u organizua Kisha e Bizantit, e cila përjetoi ndarjen definitive nga Roma në vitin 1054. Kjo ngjarje në historinë kishtarë njihet si “Skizma e madhe”. Që atëherë, kisha bizantine identifikohet me Perandorinë Bizantine, duke përkrahur fuqishëm pushtetin perandorak.

Me kohë nga kjo kishë u ndanë dhe u krijuan kishat etnike të shumicës së popujve ortodoksë të Ballkanit, por edhe të Rosisë. Me rastin e dobësimit të Bizantit, kishat ortodokse filluan të merrnin karakteristika etnike dhe të sfidonin pushtetin qendror të kishës bizantine me qendër në Konstandinopojë. Një nga qendrat e fuqishme të kishës bizantine, që nga fillimi, ishte Kryepeshkopata e Ohrit. Ajo përmbledhi numrin më të madh të peshkopatave ortodokse, që përfshinin territoret shqiptare. Kjo kryepeshkopatë administronte edhe selitë peshkopale të Nishit, Prizrenit, Shkupit, Dibrës, Kërçovës, Përlepit, Devollit, Kolonjës dhe Manastirit. Por me forcimin e shtetit bullgar në shek IX, kisha bizantine e Ohrit në këto vise mori tipare etnike bullgare. Pas vitit 1018, perandori bizantin, Bazili II, mundi bullgarët dhe Kishën e Ohrit e ktheu nën juridiksionin e kishës qendrore bizantine. Dobësimin e sërishëm të Bizantit e shfrytëzoi kisha rasiene (serbe) gjatë shek. XIII-XIV. Pas pushtimit osman të Konstandinopojës (1453), kisha bizantine vazhdoi të ishte në aleancë me sulltanët osmanë. Gjatë kësaj kohe ajo u dominua nga grekët dhe u mundua ta shtrijë ndikimin grek te popujt e Ballkanit. Në hapësirat ku u shtri Kisha Bizantine deri më sot janë ruajtur faltore dhe objekte të shumta që i takojnë stilit bizantin. Në Kosovë, në rrënojat e Ulpianës antike, janë gërmuar mbetjet e dy bazilikave bizantine të hershme. Mbetje të kishave të periudhës së hershme bizantine janë zbuluar edhe në fshatin Bellacerkë, afër Urës së Shenjtë, në fshatin Studenicë të Istogut dhe në donjë lokalitet tjetër. (Muhamet Mala)

KISHA E SHËN MIHILLIT, RAKINICË (shek. XV). Është objekt kulturi, që gjendet në fshatin Rakinicë të Malësisë së Gollakut të komunës së Podujevës. Banorët e rajonit ishin shqiptarë të krishterë ortodoksë të ritit bizantin. Kisha e Shën Mihillit në aspektin e skemës kompozicionale a planimetrike është objekt kulturi e tipit me një anijatë. I takon ndërtimeve

pasbizantine, e ngritur nga fundi i shek. XV. Kisha e Rakinicës bën pjesë në variantin e kishave të grupit kosovar të mbuluar me qemerë. Ka bazë drejtkëndëshe që mbulohet me qemer cilindrik me orientim lindje-perëndim. Përbëhet nga hajati, anijata që mbaron me absidë gjysmërrethore. Absida nga një lartësi prej 60 cm vazhdon në formë trefaqëshe, deri në çati. Kisha ndriçohet dhe ajroset me dritare në formë frëngjie. Komunikimi bëhet me anë të dy portave të mbuluara me arkitra. Portat janë të punuara me gurë të latuar. Teknika e ndërtimit është fshatare. Si material ndërtimi është përdorur guri i lidhur me llaç gëlqereje. Enterieri i kishës ishte e pikturuar me tematikë biblike. Nga piktura nuk kanë ngelur, pos fragmenteve që hasim në mbeturinat e llaçit, që kishin ngjyrë të kaltër indigo dhe okër. Plastika gurore paraqitet me profilizimet e kurorave të çatisë në murin verior dhe jugor, në portikët, dritaret, bazamentet e nikeve dhe në rozetën dekorative, e cila është e vendosur mbi derën kryesore të kishës. Kisha është restauruar dhe është kthyer në gjendjen origjinale si në aspektin arkitektonik, po ashtu edhe të profilizimit të detajeve. (Fejaz Drançolli)

KISHA E SHËN PRENËS, PRIZREN (shek. IV-XIV). Bazilikë paleokristiane në qytetin e Prizrenit. Ky ndërtim kulturi i krishterë ishte i njohur edhe si Kisha e Zojës Virgjëreshë.



KISHA E SHËN PRENËS NË PRIZREN

Në gjendje fillestare, bazilika kishte hajatin, tri anijata dhe absidë trefaqëshe, që ishte e mbuluar me qemerë. Për t'iu përshtatur nevojave liturgjike të kohës dhe shijes estetike, bazilika u shndërrua në kishë të tipit me kryq të brendashkruar, në dekadën e parë të shek. XIV. Kisha mbulohet me pesë kube. Njëra, ajo

qendrore (si në rastin e kishës në Graçanicë) është më e madhja, ndërsa katër të tjerat janë të madhësive të njëjta, por më të vogla. Në shek. XIV, mbi themelet e hajatit të vjetër u ndërtua hajati në kat, pra me galeri. Mbi hajat, në anën perëndimore u ndërtua kambanorja. Gjatë sundimit osman, kisha u shndërrua në xhami në vitin 1758 dhe u njoh si Xhuma Xhamia. Gjatë Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, më 1929 i rrënohet minarja. Pamjen e sotme e mori pas restaurimit në vitin 1951/52. Struktura e murimit është e përzier dhe përbëhet nga guri dhe tulla e pjekur. Pra, edhe kjo kishë e stilit bizantin-kosovar, është e realizuar në mënyrë alternative: një rend me gurë dhe tjetri me tulla të lidhura me llaç gëlqereje. Kjo mënyrë dhe teknikë e murimit jep efekte polikromike dhe ndikon në vlerën estetike të objektit. Pos vlerave arkitekturale, në Kishën e Shën Prenës janë me vlerë pikturat dhe freskat e saj. Disa nga këto piktura murale ekzistojnë edhe sot. Në enterierin e kishës gjenden disa shtresa të pikturave, por veçohen ato të stilit monumental të periudhës së Komnenit dhe ato të stilit narrativ të Paleologut, të pikturuara në shek XIV. Ndër piktorët e kësaj kishë ishte edhe zoografi Astrapa. Nga freskat veçohet “Zoja me Krishtin”, e pikturuar para periudhës Nemanjide. (Fejaz Drançolli)

KISHA E ZONJËS SË BEKUAR, KABASH. Gjurmët arkeologjike të Kishës së Zonjës së Bekuar gjenden në fshatin Kabash, rreth 10 km në verilindje të Prizrenit. Afër kësaj kishë, rreth 300-400 m në lindje të saj, gjendet edhe Manastiri i Shën Pjetrit në Korishë. Gërmimet arkeologjike të vitit 1963 zbuluan një ndërtesë të vogël, me bazë drejtkëndëshe dhe me absidë gjysmërrethore. Pjesa jugore e kishës është e kapur në shkëmb dhe në një shpellë të vogël. Në hyrje të shpellës është gjetur një varr i mbuluar me pllaka të vogla, në të cilin është zbuluar një skelet i shtrirë. Në shpellë janë zbuluar gjurmë të vatrës, si dhe objekte të ndryshme të qeramikës, disa prej të cilave me punim të vrazhdë, ndërsa në dyshemenë e kishës prej dheut të ngjeshur kishte edhe shumë pjesë të qeramikës së punuar mirë, që i takonin periudhës mesjetare. Në këtë kishë u zbuluan edhe enë nga argjila dhe qelqi. Kisha e Zonjës së Bekuar në shkëmbin e fshatit Kabash është njëra nga kishat e rëndësishme, e cila i takon kompleksit të madh të kishave

dhe manastireve në territorin e Kabashit dhe të Korishës. (Kujtime Boshtrakaj)

KISHA KATEDRALE E NOVOBËRDËS. Gërmadhat e Katedrales së Novobërdës dhe varrezat e vjetra rreth saj gjenden në verilindje të kështjellës. Prania e katedrales provohet nga burime relevante të kohës, si dhe nga zbulime arkeologjike. Hulumtimet arkeologjike (të nisura nga viti 1954) zbuluan muret e vjetra të stilit roman dhe ndërhyrjet arkitekturore pas pushtimit nga Perandoria Osmane, kur objekti pjesërisht ishte shndërruar në xhami me minare. Dyshemeja mendohet se është shtruar më vonë, rreth shek. XVII – XVIII. Ka studiues që mendojnë se ky monument kulti ka qenë seli e Kishës Romane-Katolike ose ipeshkvi. Gërmimet arkeologjike të viteve ‘50 kanë zbuluar fragmente të themeleve të një kishë më të vjetër sesa katedralja, me dimensione 16,40 x 11,50 m (pa absidë) dhe objektin e ri të katedrales të ndërtuar në shek. XV, me dimensione 15, 25 x 20,50 m dhe gjatësi 31,65 m. Katedralja në anën perëndimore ka një zgjatje drejtkëndëshe në formë të kryqit, ndërsa në pjesën qendrore ishte kubeja që peshonte mbi shtyllat rrethore, të punuara nga gurët me ngjyrë të kuqërremtë dhe dy kupola të tjera në anën perëndimore, që po ashtu peshonin në shtylla rrethore, me teknikë të njëjtë të ndërtimit. Brenda hapësirës së katedrales sot vërehen shtyllat e thyera në formë të rrumbullakët, ndërsa në disa vende gjenden bazat e këtyre shtyllave prej guri me tri shtresa. Në rrënojat e mureve të katedrales vërehen gurët e mureve të latuar dhe gjysmë të latuar. Gurët që lidhin qoshet e katedrales janë me dimensione të mëdha dhe dallohen edhe për nga ngjyra: disa kanë ngjyrë të kafesë së çelët e disa të murrme në të bardhë. Katedralja i kishte tri porta hyrëse në hapësirën e narteksit të brendshëm. Në anën e saj lindore ishte ngritur nekropoli i madh i rrethuar gjithashtu me mure. (Qazim Namani)

KISHA KATOLIKE NË KOSOVË. Kisha e krishterë që e njeh papën si kreun e vet, në mënyrë të veçantë ajo që u zhvillua pas ndarjes së Kishës në vitin 1054 dhe pas Reformacionit. Kisha Katolike që tubon rreth vetes të gjithë besimtarët katolikë të Kosovës, është e pranishme në këto treva që në shekujt e parë të krishterimit. Me ndarjen e Perandorisë Romake në dy pjesë (viti 395), edhe pse



KATEDRALJA SHËN TEREZA NË PRISHTINË

politikisht i përkiste Perandorisë së Lindjes, kisha e prefekturës së Ilirikut përgjithësisht dhe ajo e Dardanisë në veçanti mbeti e lidhur me Romën. Gjatë rivalitetit midis Romës e Konstandinopojës për ndikim në Ballkan, ipeshkvijtë e Dardanisë mbajtën anën e Papës. Me ndarjen zyrtare të krishterimit (1054) në Kishën Katolike me qendër në Romë dhe në Kishën Ortodokse me qendër në Konstandinopojë, territoret shqiptare u ndanë midis dy qendrave të mëdha të botës së krishterë. Territoret e Kosovës, edhe pse nën sundimin politik bizantin e bullgar, në aspektin kishtar kryesisht ishin të orientuara drejt krishterimit perëndimor, romano-katolik nën autoritetin e Papës. Pas sulmeve sllave, besnikëria ndaj Romës do të dëshmohej në Argjipeshkvinë dhe Ipeshkvinë e Shkupit, e cila do ta trashëgojë juridiksionin kishtar të Argjipeshkvisë Justiniana Prima. Gjatë sundimit bullgar dhe të bizantit, kishat e trevave të Kosovës mesjetare (Shkupi, Prizreni, Lipjani etj.), u vendosën në kuadër të Argjipeshkvisë së Ohrit. Pushtimi i Kosovës nga nemanjidët e gjeti këtë vend me një bashkësi katolike të konsiderueshme. Pas pavarësimit të kishës nemanjide nga kryepeshkopata e Ohrit (1219), veprimtaria e Kishës Katolike në Kosovë u vështirësua nga politika e represionit dhe e konvertimit me dhunë të katolikëve shqiptarë në Kosovë. Ndonëse në kushte të vështira, një pjesë e bashkësive katolike do të vazhdonjë të ekzistojnë gjatë sundimit osman. Kisha

Katolike (Argjipeshkvia e Prizrenit) u ripërtëri sidomos pas themelimit të Kongregatës së Propagandës Fide (1622), kur edhe filloi rivendosja dhe riaktivizimi i klerit dhe i Kishës Katolike Shqiptare në Kosovë.

Deri më 1914 Kisha Katolike në Kosovë administrohej në nivel të argjipeshkvisë, kurse pas këtij viti Argjipeshkvia Shkup-Prizren mbetet ipeshkvi. Prej vitit 1821 deri më 1934 rezidencë ipeshkvnore ka qenë Prizreni dhe pastaj selia kaloi në Shkup. Në vitin 1969, Selia e Shenjtë sërish bëri riorganizimin territorial-administrativ kishtar në këto treva: u ripërtëri Ipeshkvia e dikurshme e Prizrenit, tani Ipeshkvia Shkup-Prizren. Nga Kisha Katolike në Kosovë kanë dalë personalitete të mëdha të kombit dhe fesë. (Gjon Berisha)

KISHA RASIANE. Njëra ndër kishat autoqefale ortodokse, e themeluar në periudhën mesjetare në pjesën jugore të Serbisë së sotme me qendër në Ras. Në fillimet e krishterimit, kishat në territorin e Rashës ishte nën juridiksionin latin perëndimor, por nga mesi i shek IX fillon veprimtaria misionare e fuqishme lindore nga Konstandinopoja. Në vitin 1186 në Rashë zhupani Stefan Nemanja thirri kuvendin shtetëror-fetar, me të cilin u vendos përndjekja e herezisë bogumile në zhupaninë e tij. Me këtë u forcua kisha ortodokse bizantine, që më vonë rezultoi edhe me krijimin e kishës autoqefale rasiene (1219), duke larguar ndikimin politik bizantin dhe duke forcuar atë sllavo-ortodoks. Selia e kryepeshkopatës u caktua te Manastiri Zhiça, në afërsi të Kralevës (Serbi). Për shkak të sulmeve të fiseve tatarë kumane, selia e kishës më vonë u zhvendos në qytetin e Pejës, por u rikthye më vonë prapë në Zhiçë. Kisha është forcuar dhe zhvilluar në kohën e mbretit nemanjid, Milutinit, i cili bëri përshtatjen dhe adaptimin e shumë manastireve paleokristiane në stilin bizantin-ortodoks, disa nga ato edhe në territorin e Kosovës. Pas pushtimeve territoriale që bëri Stefan Dushani në Shkup më 1346, kishën rasiene e ngriti në rangun e Patrikanës. Pas rënies së despotatit serb nën pushtimin osman (1459), kisha rasiene pushoi se ekzistuar, përkatësisht i bashkëngjitet Kryepeshkopatës së Ohrit (1463). Në vitin 1557 veziri i madh, Mehmet pashë Sokoloviqi, me origjinë sllave nga Hercegovina, riktheu sërish Patrikanën e Pejës me juridiksion në një territor të gjerë, që përfshinte edhe Kosovën. Në selinë e

patriarkut e emëroi vëllanë e vet, Makarije Sokoloviçin. Patrikana u suprimua sërish në vitin 1766, kurse pronat dhe qeverisjen e mori Patrikana e Stambollit, që udhëhiqej nga grekët fanariotë. (Muhamet Mala)

KISHA ROMANE-KATOLIKE. Është kisha e krishterë që e njej papën si kreun e vet, në mënyrë të veçantë ajo që u zhvillua pas ndarjes së kishës më 1054 dhe pas Reformacionit më 1517. Kjo kishë ishte e pranishme në këto treva që në shekujt e parë të krishterimit. Me ndarjen e Perandorisë Romake në dy pjesë (395), edhe pse politikisht i përkiste Perandorisë së Lindjes, Kisha e prefekturës së Ilirikut përgjithësisht, dhe ajo e Dardanisë në veçanti, mbetet e lidhur me Romën. Letrat e papëve të parë provojnë lidhjet e ngushta të tyre me ipeshkvijtë e Dardanisë dhe të Dioklesë (provincës së Prevalit). Gjatë rivalitetit midis Romës e Konstandinopojës për ndikim në Ballkan, ipeshkvijtë e Dardanisë vendosmërisht mbajtën anën e papës. Justiniani, përmes novelave të njohura të tij (535, 545), që ndërlidhen me krijimin e qendrës së dytë të kishës në Ilirik me seli në Justiniana Prima, bën të ditur se ajo qendër kishte nën juridiksion edhe Dardanië dhe Prevalin. Prandaj juridiksioni i Mitropolisë Justiniana Prima ishte përcaktuar qartë si “përfaqësues i Selisë Apostolike të Romës.”

Me ndarjen zyrtare të krishterimit (1054) në Kishën Katolike me qendër në Romë dhe në Kishën Ortodokse me qendër në Konstandinopojë, territoret shqiptare u ndanë midis dy qendrave të mëdha të botës së krishterë. Në territorin e sotëm të Kosovës, edhe pse nën administrimin politik bizantin, përveç shtrirjes së juridiksionit të kishës bizantine, hetohej dukshëm edhe orientimi drejt krishterimit perëndimor, romano-katolik, nën autoritetin e papës, si dhe ndikimi i qendrave më të mëdha romano-katolike arbërore dhe dalmate: Tivarit, Kotorrit, Raguzës, Shkodrës, Pultit, Drishtit etj. Me gjithë dëmet që iu shkaktuan hierarkisë kishtarë dardane nga sulmet gote, hune, sllave, avare e bullgare, vazhdimësia e saj dhe besnikëria ndaj Romës do të dëshmohej në Ipeshkvinë e Shkupit (e përmendur përsëri në shek. IX). Pushtimi i territorit të sotëm të Kosovës nga nemajidët e gjeti këtë vend me një bashkësi katolike të qëndrueshme. Politika e represionit dhe e konvertimit me dhunë të katolikëve arbër, sidomos në Kosovë dhe

në Zetë (Mali i Zi) nga ana e nemanjidëve, veçanërisht nga Stefan Uroshi II (Milutini) është sanksionuar edhe në kapituj “antiherezi” të Kodit të Stefan Dushanit. Në këto kapituj të Kodit të Dushanit dhe në dokumente të shumta papale, në vazhdimësi bëhet fjalë për “fenë latine”, “besimtarët latine” e “priftërinj latinë”, të shtrirë në gjithë teritorin e sotëm të Kosovës.

Prania e Kishës Romane-Katolike në Kosovë do të dëshmohej edhe nga letrat e shumta të papëve të Romës dhe Avinjonit, me qendra e bashkësi katolike të shumta në Shkup, Prizren, Novobërdë, Trepçë, Graçanicë, Janjevë, Prishtinë etj. Një pjesë e këtyre bashkësive vazhduan të ekzistonin gjatë gjithë historisë, deri në ditët e sotme. (Gjon Berisha)

KISHA SASE E NOVOBËRDËS, TREPÇËS DHE JANJEVËS.

Dëshmia më e vjetër për ekzistimin në Novobërdë të një kishë të sasëve rrjedh nga viti 1346, kur midis kishave katolike (të Prizrenit, Janjevës, Koporiqit, Pllanës, Rudnikut e Bërskovës) dëshmohej edhe Kisha e Shënkollit në Novobërdë. Dihet se ka ekzistuar edhe një kishë kushtuar Shën Mërisë, e cila gjendej në nëngjyretin e poshtëm, përkatësisht në katundin e sotëm Bostan, rrëzë Novobërdës. Për kishën e tretë sase, që nuk ishte as ajo e Shën Kollit, as ajo e Shën Mërisë, nuk dihej deri në vitet '50 të shekullit të kaluar, kur në Novobërdë u bënë gërmime arkeologjike. Për sa i përket aspektit arkitektonik, ka mendime se ajo ishte kishë e tipit gotik, ndërsa të tjerët mendojnë se ishte e tipit roman. Ka studiues që mendojnë se ajo kishë u ndërtua nga vetë sasët, përkatësisht se ishte kishë gotike. Mbetje të një kishë të vjetër katolike, e quajtur Kisha e Sasëve, janë ruajtur edhe në Stantërg të Mitrovicës, nën kodrinën pas godinës së minierës. Kjo kishë u ngrit gjatë gjysmës së parë të shek. XIII dhe ishte një godinë e madhe me tri harqe (21x16 m), tek e cila hetohet kryqëzimi i artit gotik dhe të atij bizantin. E parë nga dimensionet e saj, kjo kishë bie në radhën e godinave më të mëdha mesjetare të Kosovës. Deri në ditët tonat është ruajtur vetëm absida e godinës me fragmente nga jetëshkrimi në dy shtresa, i punuar gjatë shek. XIII e XIV.

E sasëve do të ketë qenë edhe kisha e kryehershme e Janjevës, ngase qyteti, para ardhjes së raguzanëve, banohej kryesisht nga sasët. Ata e kishin kishën e tyre të Shën Kollit, e cila më

vonë u bart në lokacionin e sotëm. Në kishën e sotme të Janjevës jo vetëm kambana më e vogël (që është sjellë nga Këlmi i Gjermanisë, 1368) mban mbishkrim gotik, por këtu është e murosur edhe një pllakë guri me shkronja gotike, e cila është sjellë po nga Kisha e moçme sase e Shën Kollit, si dhe disa pllaka të tjera më të vonshme me shkronja latine. Mbishkrimet me alfabet latin do të jenë të kohës pas ngritjes së kolonisë së raguzanëve, e cila për herë të parë dëshmohet në vitin 1433. (Skënder Gashi)

KISHAT E STILIT BIZANTIN (shek. IV-1455). Janë objekte kulturi të ritit bizantin ortodoks, të ndërtuara që nga periudha e artit paleokristian e deri më rënien e Kosovës nën sundimin osman (shek. V-1455). Karakteristikë e kishave të këtij stili është planimetria e ndërtimeve, mbulesa dhe struktura e ndërtimit arkitektural. Kishat i takojnë tipit bazilikë, me kryq të brendashkruar me kube. Kisha me kryq të brendashkruar e formojnë kryqin nga mbulesa, me sistem qemerësh në enterier dhe me çati të lartësive të ndryshme. Ndërtimet (dhe rindërtimet) janë të mbuluara me një (kishat në Patrikanën e Pejës) dhe pesë kube të tipit bazilikë (Manastiri i Graçanicës dhe Kisha e Shën Prenës në Prizren, si dhe rrënojat e kishës "Burgu" në Hajnoc të Kamenicës, Studenica e vogël në Vrellë të Istogut, kisha në kalanë e Harilaqit, në Ulpianë, Municipum D.D etj.). Ka pasur edhe kisha apo kishëza të mbuluara vetëm me qemerë, që u takonin ndërtimeve të artit të periudhës së krishterimit të vjetër (shek. V-VI). Kubet dhe absidat janë shumëfaqëshe dhe rrethore. Pos hajatit, anijatës dhe absidës kanë transeptin, proskomidin, diakonikonin e në raste të veçanta edhe kriptën. Lidhen me portale të mbuluara me arkitra apo hark, e ndriçohen dhe ajrosen me dritare të mbuluara me hark. Nga ana e jashtme kishat e stilit bizantin-kosovar i karakterizon fasada e muruar. Në disa raste murimi është alternativ: një rend me gurë, tjetri rend me tulla të pjekura dhe të lidhura me llaç gëlqereje. Muret nuk janë të suvatuara. Materiali ndërtimor, pos që kishte për qëllim përforcimin e konstruksionit, i jepte fasadës pamje piktoreske, e cila me kohë u bë formë kryesore e dekorimit. Pos trajtave dhe plastikës, në dekorim përfshihej edhe harmonia e ngjyrave të tullave, të llaçit dhe të gurëve. Kjo mënyrë dhe strukturë e murosjes është me ndikim nga stili oriental i ndërtimit dhe i dekorimit. (Fejaz Drançolli)

KISHAT KATOLIKE TË PERIUdhËS OS-MANE. Ndryshe nga Kisha Ortodokse me seli në Konstandinopojë (Stamboll), e cila kishte arritur që në vitin 1453, nëpërmjet fermanëve dhe berateve të lëshuara nga sulltani të fitonte mbrojtjen e objekteve të kultit ortodoks, Roma si seli ekumenike katolike, zgjodhi rrugë tjetër. Vetë Papati u vendos në krye të luftës antiosmane. Kjo rrethanë bëri që në kohën e pushtimeve osmane (shek. XV-XVIII) të pushojnë së vepruari një sërë dioqezash dhe famullish arbërore katolike. Dobësimi i organizimit kishtar shoqërohej edhe me degradimin e monumenteve të kultit katolik, të cilat ose u rrënuan, ose u shndërruan në monumente të kultit islam. Në anën tjetër, pas fermanit të sulltan Sylejmanit të vitit 1557, Patrikana e Pejës përfitoi nga privilegjet osmane dhe bëri rindërtimin edhe të kishave katolike, besimtarët e të cilave me kohë ishin konvertuar në ortodoksë, ose kishin marrë rrugën e mërgimit.

Pas pushtimeve osmane u shfaqën ndryshime të rëndësishme edhe në organizimin kishtar edhe në trevat arbërore, pra edhe në Kosovë. Deri në vitin 1420 kishat katolike në Kosovë qenë nën juridiksionin e Ipeshkvisë së Kotorrit, mirëpo kjo ipeshkvi, pas rënies nën Republikën e Venedikut, kishte humbur primatin, duke ia lëshuar atë Argjipeshkvisë së Tivarit, që për herë të parë është shuguruar në Katedralen e Novobërdës në vitin 1458. Njoftime të hollësishme për këtë monument sakral ofron edhe relacioni i argjipeshkvit të Tivarit, Marin Bici, i hartuar me rastin e udhëtimit të tij në Kosovë (1610). Përveç përshkrimit të gjendjes së monumenteve sakrale katolike në Novobërdë, ai flet edhe për një faltore katolike në Trepçë, për një kishë katolike në Janjevë, për një tempull "Latin" në Prizren (Zoja e Bekuar), i cili fillimisht qe plaçkitur dhe pastaj ishte djegur. Dy dekada më herët, vizitori A. Komuloviq shkruante se në vitin 1584 Prishtina ishte vend i këndshëm, ku dikur jetonte ipeshkvi, ndërsa në kohën e tij nuk kishte fare klerikë. Ndërsa Pjetër Mazreku, ipeshkëv i Tivarit me origjinë nga Prizreni, në vitet 1622-24 bën fjalë për konvertimin e popullatës katolike të trevës së Prizrenit, duke i përmendur edhe monumentet e vjetra të kultit në këtë anë. Në një relacion të vitit 1633, Mazreku zë në gojë kishat katolike Shën Pjetri Apostull në Trepçë, Shën Nikolla në Janjevë,

Shën Gjergji në Letnicë, si dhe Kishën e Shën Nikollës në Novobërdë. Sipas një regjistri të vitit 1638, që i referohet edhe popullatës katolike të Kosovës, përmenden disa kisha parokiale në rrethe të Prizrenit, si dhe në Suharekë e Has. Njoftime të hollësishme për kishat katolike në periudhën osmane ndeshim edhe te Gjergj Bardhi (1639-1642). Përveç kishave të përmendura më lart (në Prizren dhe rrethe, Janjevë, Letnicë dhe Novobërdë), ai bën fjalë edhe për Kishën e Shën Nikollës në Gjakovë, për disa monumente të Karadakut të Shkupit, për kompleksin e Patrikanës Ortodokse të Pejës etj. Kuadrin e monumenteve të kultit katolik e plotësojnë edhe Ndre Bogdani (1644), famullitari Mark Babiq (1649-1650), argjipeshkvi i Sofjes, Bakshiq, (1643), Pjetër Bogdani, Fra Bernardini etj. (Jahja Drançolli)

KISHAT ORTODOKSE TË PERIUdhËS OSMANE. Osmanët kishin qëndrim të qartë për fatin e monumenteve fetare në vendet e pushtuara. Nëse një qytet ose një vend bënte rezistencë, përveç masave ndaj luftëtarëve rrënoheshin edhe objektet e kultit të krishterë, ose ato shndërroheshin në xhami. Në anën tjetër, nëse qyteti ose vendi dorëzohej pa luftë, atëherë, banorët ruanin të drejtën të kryenit ritet fetare në objektet e tyre të kultit. Ky model u ndoq afërsisht edhe në raport me objektet e kultit katolik dhe ortodoks në Kosovë, e cila përfundimisht ra nën osmanët më 1455 (Prizreni më 1459, Peja më 1462). Dokumentet e kohës flasin për rezistencën e fortifikatave të njohura, si në Prizren, Novobërdë, Zveçan, Trepçë etj. Pas rënies së tyre, ndodhi edhe rrënimi i faltoreve kryesore ose shndërrimi i tyre në faltore islame. Në Prizren janë të njohura dy faltore katolike të shndërruara në xhami. Ndryshe prej Kishës Katolike, Kisha Ortodokse rasiene, duke qenë e përkrahur nga Patrikana e Konstandinopojës, me fermanin e Sylejmanit Ligjdhënës të vitit 1557 do të ngritet në rangun e Patrikanës, me seli në Pejë. Tani Patrikana e Pejës fitoi privilegje nga osmanët, përfshirë edhe të drejtën e rindërtimit të kishave të rrënuara dhe ndërtimin e faltoreve të reja në territorin e Kosovës së sotme. Faltore ortodokse me numër më të madh u ndërtuan në treva ku dikur jetonin kolonistë katolikë: raguzanë, italianë, saksonë (gjermanë), koto-rras etj., sidomos në Anamoravë, në rajonin e Trepçës, të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Llapit.

Këto privilegje të realizuara pas vitit 1557 morën dimension të ri sidomos pas Betejës së Lepantit (1571), kur murgjit ortodoksë filluan t'i politizonin monumentet e kultit. Sipas defterit osman të vilajetit Vëllk (1455) ishin të regjistruara vetëm tri kisha në të cilat jetonin dhe vepronin murgjit. Mundësia e rindërtimit të objekteve kishtarë pas vitit 1557 u shfrytëzua në masë të madhe, së pari në vetë Patrikanën e Pejës, pastaj në Graçanicë, Prizren etj. Nga kjo kohë janë të njohura më se njëqind faltore të ndërtuara ose të rindërtuara. Gjithashtu janë ruajtur edhe emrat e mecenëve dhe donatorëve të monumenteve të kultit, pjesa më e madhe e të cilëve ishin spahinj të krishterë dhe vojvodë. Në Kosovë, në atë kohë, u paraqit edhe një kategori e veçantë e rojeve të manastireve, të quajtur vojvodë, të tillë siç ishin në Deçan, Deviq (Drenicë), Korishë (Shën Pjetri), Pejë (kompleksin e Patrikanës), Sokolicë (Mitrovicë) etj. Për shfaqjen e kësaj kategorie të rojave të kishës ka pasur ndikim edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili detyronte pothuajse çdo njësi parokiale, bajrak ose fis të kujdeset për mbrojtjen e kishës, të pasurisë së saj dhe besimtarëve përreth. (Jahja Drançolli)

KISHAT PALEOKRISTIANE. Kisha të krishterimit të hershëm. Krishterimi ishte kudo religjion i përndjekur nga Perandoria Romake në shekujt e parë të përhapjes, ndonëse besimet e tjera ishin të lejuara. Të krishterët e parë i kryenin ritet në fshehtësi, kryesisht në hapësira të fshehta në tokë, të quajtura katakombe. Me pas filluan të ndërtohen kisha të vogla, ndonëse përndjekja e tyre vazhdoi. Gjendja ndryshoi me shpalljen e "Ediktit të Milanit" të vitit 313, kur u lejua dhe krishterimi. Rol vendimtar për shpalljen e këtij edikti, të njohur dhe si "Edikti i Tolerancës", luajti Konstantini i Madh, perandor romak me prejardhje nga Dardania. Pas këtij viti filloi përhapja e lirë e besimit të krishterë dhe nisën të ndërtohen kishat, të njohura me emrin bazilika dhe në historiografi njihen si kisha të krishterimit të hershëm (kisha paleokristiane). Në fazat e hershme u ndërtuan edhe objekte për pagëzim me pishina (baptistere), ku futeshin të rriturit e konventuar në të krishterë. Në Kosovë është mjaft e dendur prezenca e strukturave të arkitekturës paleokristiane, por këto nuk janë mjaft të studiuara. Të tilla janë bazilikat/kishat në Ulpianë, Vërmicë, Korishë, Vrellë, Kasterc,

Banjicë, Trubohoc, Dragolec, Izbicë, Harilaq, Miradi e Ulët, Lipjan, Reçak etj. Në vitin 2014 u zbulua në Ulpianë dhe baptisteri i parë i njohur në Kosovë. (Arben Arifi)

KLARK Ueslli (Wesley Clark) (1944-). Komandant suprem i forcave të Aleancës Veri-Atlantike në Europë (NATO) në periudhën 1997-2000. Lindi në Çikago, Illinois të SHBA-së.



UESLLI KLARK

Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Little Rock. Më 1962 u pranua në Akademinë ushtarake të SHBA-së në Ust Point të Nju-Jorkut, ku diplomoi në qershor të vitit 1966. Më 1968 diplomoi për filozofi, politikë dhe ekonomi në Universite-

tin e Oksfordit. Përveç anglishtes, flet spanjisht, gjermanisht dhe rusisht. Nga maji i vitit 1969 deri në shkurt të vitit 1970 shërbeu në Luftën e Vietnamit, ku edhe ishte plagosur. U. Klark kishte pozita të ndryshme në hierarkinë e lartë ushtarake dhe politike në SHBA, ndër të tjera edhe komandant suprem i Forcave Aleate në Europë (NATO), nga korriku 1997 deri në maj të vitit 2000. U. Klark ishte në krye të forcave të NATO-s gjatë ballafaqimit ushtarak me Jugosllavinë në luftën e Kosovës të vitit 1999. Pas fushatës 78 ditëshe të bombardimeve, NATO deklaroi se nuk kishte pësuar asnjë humbje njerëzore. Kështu U. Klark u bë gjenerali i parë i SHBA-së që fitoi një luftë pa asnjë humbje. Pas largimit të tij në vitin 2000, presidenti Bill Clinton e nderoi me Medaljen Presidenciale të Lirisë. Në vitin 2001 Klark botoi librin “Bërja e luftës moderne: Bosnja, Kosova dhe e ardhmja”. (Naim Musliu)

KLEJER Natali (Nathalie Clayer) (1960-). Historiane franceze. Është drejtuese kërkimesh studimore në CNRS (Qendra Kombëtare e Kërkimeve Shkencore, Laboratori i Studimeve Turke Osmane, Ballkanike dhe për Azinë Qendrore) në Paris. Specialiste e çështjeve identitare, e cila merret në veçanti me tarikatet mistike myslimane. Ka botuar, së bashku me Ksavier Bugarelin, librin “Islami i ri ballkanik” (Paris, 2001), në të cilin trajton marrëdhëniet e reja të islamit me politikën në Ballkanin paskomunist. Hapësira shqiptare e kohës osmane dhe asaj pasosmane ka qenë tema kryesore e studimeve të

saj të fundit. Ka botuar veprën “Shqipëria vendi i dervishëve” (1990) dhe “Feja dhe kombi në mesin e shqiptarëve, shek. XIX-XX)” (2003). Në historiografinë shqiptare është bërë e njohur sidomos me veprën “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar - lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë” (2007). (Fitim Rifati)

KLINA. Qytet dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Nodhet rreth 60 km në perëndim të Prishtinës. Më 4 gusht të vitit 1977 shpallet qytet. Me emrin Klina e Pashës është regjistruar



KLINA

në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të viteve 1893, 1896 dhe 1900. Në hartën ushtarake austriake (1689) është regjistruar me emrin Glina. Është një e rëndësishme komunikuese, e cila lidh shumë qendra urbane të Kosovës. Në afërsi të Klinës kalon hekurudha Pejë-Fushë Kosovë e ndërtuar në vitin 1936 dhe rrugë të tjera magjistrale që lidhin vendbanimet e Rrafshit të Dukagjinit me ato të Rrafshit të Kosovës. Në vitin 2011 kishte 5,542 banorë, ndaj 630 banorëve në vitin 1948. Është qendër arsimore, ka shkollën 9-vjeçare dhe dy shkolla të mesme. Nga objektet e tjera të standardit shoqëror ka qendrën shëndetësore, shtëpinë e kulturës, disa njësi tregtare dhe shërbyese. Në vitin 1971 rreth 86% e popullsisë aktive ka qenë e inkuadruar në sektorin primar. Përqindja e lartë dhe me ritme të ulëta të rënies së popullsisë aktive bujqësore tregon për transformimin e ngadalshëm social, ekonomik dhe funksional të kësaj qendre. (Ferim Gashi)

KLINA (komuna). Komunë në Rrafshin e Dukagjinit, rreth 60 km në perëndim të Prishtinës. Sipërfaqja e territorit të komunës është 308.8 km². Shtrihet në pjesën verilindore të Rrafshit të

Dukagjinit dhe bën pjesë në trevën kodrinore-malore të Llapushës. Pjesën veriore dhe verilindore të territorit të komunës e përbëjnë viset malore të Llapushës dhe të Drenicës, ndërsa pjesa perëndimore dhe ajo qendrore zbret në Rrafshin e Dukagjinit. Viset që i takojnë Rrafshit të Dukagjinit i përkasin zonës deri në 500 m të lartësisë mbidetare, ndërsa pjesët e skajshme shtrihen ndërmjet 500-700 m. Në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skënderajin dhe Drenasin, në jug me Malishevën dhe Rahovecin, ndërsa në perëndim me Pejën. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i popullsisë në komunën e Klinës është 38,496 banorë në vitin 2011, ndaj 42,813 banorëve në vitin 1981. Prej tyre në qytet jetojnë 5,908 banorë ose 15.4%, ndërsa në vendbanime rurale jetojnë 32,588 banorë ose 86.4% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Dendësia e popullsisë është 124 b/km². Dominon popullsia e moshës së re (15-29 vjeç). Rreth 31% të popullsisë janë nën moshën 14 vjeçare dhe 67% janë nën moshën 29 vjeçare. Rrjetin e vendbanimeve të komunës e përbëjnë 57 fshatra të organizuara në 13 bashkësi lokale dhe qendra urbane e Klinës. Rrjetin e shkollave në komunën e Klinës e përbëjnë: një institucion parashkollor, 15 shkolla fillore me 10 paralele të ndara dhe dy shkolla të mesme. Shërbimet shëndetësore ofrohen nga qendra kryesore e mjekësisë familjare në qytezën e Klinës, tri qendra të mjekësisë familjare në Zllakuqan, Ujmir dhe Sferkë dhe dhjetë stacione shëndetësore të shpërndara nëpër fshatrat e komunës. Aktivitetet kulturore zhvillohen në shtëpinë e kulturës “Jehona e Dukagjinit” në Klinë. (Ferim Gashi)

KLINAKU Avni (1965-). Aktivist politik, një-ri nga themeluesit dhe kryetar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) dhe i Lëvizjes për Bashkim.



AVNI KLINAKU

Lindi në fshatin Bivolak të komunës së Vushtrrisë. Pasi kreu shkollimin fillor dhe të mesëm ndoqi studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës. Më 1982 iu bashkua Frontit për Çlirim Kombëtar dhe më pas u burgos dhe u dënua me 5 vjet heqje lirie. Veprimtarinë politike e vazhdoi gjatë viteve '90. Më 1993 ishte njëri nga

themeluesit e LKÇK-së dhe i grupeve të para të armatosura. LKÇK-në e udhëhoqi deri në vitin 1997. Ishte kryeredaktor i gazetës “Çlirimi”, organ i LKÇK-së, kur u arrestua për herë të dytë dhe u dënua me 10 vjet burg nga gjykata serbe e Prishtinës. Më 19-24 maj 1999 përjetoi masakrën e burgut të Dubravës. Më pas, bashkë me të mbijetuarit e tjerë, u zhvendos në burgun e Lipjanit, ndërsa më 10 qershor 1999 u transferua në burgun e Nishit, prej nga u lirua në vitin 2001. Në vitin 2007, bashkë me disa veprimtarë të tjerë, themeloi Lëvizjen për Bashkim, të cilën e udhëhoqi deri në vitin 2015. Është autor i shumë shkrimeve publicistike. (Ilir Ulaj)

KLINAKU Hysni (1975). Tenor. Lindi në Obiliq, ku mori arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu Fakultetin e Arteve, drejtimin e solo-këndimit, në Prishtinë (1996). Ishte solist në Ansamblin “Shota” në vitet 2000-2003, ndërsa në vitet 2003-2005 në Filarmoninë - Operën e Kosovës. Me vënien në skenë të operës “Dasma arbëreshe” të R. Dhomit interpretoi rolin e Kalorësit. Më 2006 mbajti koncert solistik në Prishtinë me këngë të përpunuara popullore. Gjatë studimeve pasuniversitare (2009) në Fakultetin e Muzikës në Shkup u prezantua me Filarmoninë e Maqedonisë. Më 2010 përfundoi magistraturën dhe mbajti koncert solistik në Shkup dhe në Prishtinë. Është pjesëmarrës në festivale, koncerte, xhirime televizive me këngën popullore dhe muzikë të lehtë shqipe. Ka realizuar nëntë albume: tetë me muzikë popullore dhe një me këngë nga kompozitorë shqiptarë. (Besa Luzha)

KLINAKU Istref (1958-). Inxhinier i makinerisë. Lindi në fshatin Bivolak, komuna e Vushtrrisë. Shkollimin fillor e mbaroi në Obiliq, gjimnazin në Prishtinë. Fakultetin Teknik, drejtimi i makinerisë termoenergjetike, e mbaroi në Universitetin e Prishtinës (1982). Pas diplomimit punësohet si inxhinier në kombinatin “Kosova” të Obiliqit, ku vazhdon të punojë edhe tash. Nga viti 1999 deri në fund të vitin 2002 ka qenë drejtor ekzekutiv i Termocentraleve të Kosovës, ndërsa një vit edhe i minierave të qymyrit. Në periudhën 2003-2006 ka qenë menaxher projekti në divizionin për prodhim të energjisë elektrike dhe më pas drejtor ekzekutiv në divizionin për prodhim të energjisë. Bëri shumë vizita

pune dhe trajnuese në shumë termocentrale të Europës, si dhe në kompani të specializuara për punë në sektorin e prodhimit dhe të mirëmbajtjes së termocentraleve me qymyr. (Fejzullah Krasniqi)

KLINAKU Shukri (1967-). Politikan, mësimdhënës universiteti. Lindi në Mazgit, shkolimin bazë e kreu në Obiliq dhe në Prishtinë, ndërsa studimet për fizikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës (UP), kurse studimet pasuniversitare dhe doktoratën i kreu në Tiranë dhe Freiberg të Zvicrës. Aktivisht u mor me politikë në periudhën 1981-2002. Për aktivitetet politike kundër regjimit serb ishte burgosur në vitet 1985-1986. Në vitin 1990 ishte anëtar i kryesisë themeluese të Unionit të Pavarur të Studentëve të UP-së. Në vitin 1993 ishte ndër themeluesit dhe më vonë nënkryetar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK). Ishte anëtar i redaksisë së gazetës “Çlirimi” (organ i LKÇK-së) dhe më vonë edhe kryeredaktor i saj. Pas luftës (1999) u emërua zëvendësministër i informimit në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës dhe anëtar i Këshillit Transitor të Kosovës (2000). Prej vitit 2008 është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes për Bashkim. Nga viti 2002 u përqendrua në mësimdhënie në FSHMN të UP-së. Botoi studime nga fusha e fizikës dhe disa libra universitarë: “Lëvizja relative dhe gabimet e Ajnshtajnit” (2012), “Hyrje në astronomi” (2015) etj., si dhe libra me përmbajtje politike: “Vendimi fatal”, (2000) dhe “Pse fitoj LDK-ja në zgjedhjet e 2000”, (2001). (Ali Cenaj)

KLINIKAT E QKUK-së. Mbështetur në Ligjin për shëndetësi të Kosovës nga viti 2013, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me klinikat dhe njësitë e tjera përbërëse, bëhen pjesë përbërëse organizative dhe funksionale të shërbimit spitalor dhe klinik universitar të Kosovës (SHSKUK). Sipas statutit të QKUK-ës i miratuar më 2014 klinikat dhe shërbimet mjekësore të kësaj qendre janë: Klinika e Anestezionit dhe Reanimimit, Klinika e Kirurgjisë Abdominale, Klinika e Neurokirurgjisë, Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve, Klinika e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Lokomotore, Klinika e Urologjisë, Klinika e Kirurgjisë Torakale, Klinika e Kirurgjisë Vaskulare, Klinika e Kirurgjisë Plastike, Klinika Obstetrike-Gjinekologjike,

Klinika e Sëmundjeve të Veshit, Hundës dhe Fytit; Klinika e Sëmundjeve të Syrit, Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale, Klinika e Kardiologjisë, Klinika e Reumatologjisë, Klinika e Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike, Klinika e Endokrinologjisë, Klinika e Pastroenterologjisë me Hematologji, Klinika e Hematologjisë, Klinika e Nefrologjisë, Klinika e Sëmundjeve Ngjitëse, Klinika e Psikiatrisë, Klinika e Neurologjisë, Klinika e Dermatovenereologjisë, Klinika e Pediatriisë, Klinika e Neonatologjisë, Klinika e Pulmologjisë, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim dhe Mjekësi Sportive, Klinika e Biokimisë Mjekësore, Klinika e Radiologjisë, Klinika e Onkologjisë, Shërbimi Klinik i Emergjencës, Shërbimi Klinik i Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive, Shërbimi Klinik i Mjekësisë Nukleare dhe Instituti i Psikiatrisë Forenzike. Aktualisht në QKUK punojnë 2,594 punëtorë, prej të cilëve: 457 janë mjekë, 6 stomatologë, 3 farmacistë, 17 fizioterapeutë (baçelor), 1,630 infermierë, 29 bashkëpunëtorë dhe 452 punëtorë jomjekësorë. Njësi përbërëse të QKUK-së gjithashtu janë institutet e Fakultetit të Mjekësisë, të cilët, krahas rolit edukativ-hulumtues, ofrojnë edhe shërbime shëndetësore për nevojat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Institutet e Fakultetit të Mjekësisë janë: Instituti i Anatomisë, Instituti i Fiziologjisë, Instituti i Histologjisë me Embriologji, Instituti i Anatomisë Patologjike, Instituti i Fiziologjisë Patologjike dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore. Këto institute kanë të punësuar 60 punëtorë, prej të cilëve 37 janë mjekë me tituj prej asistentit e deri të profesorët ordinarë. (Avdyl Krasniqi)

KLINTON Bill (William Jefferson Clinton)

(1946-). President i SHBA-së. Lindi në Hope (Arkansas). Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Hot Springs, kurse studimet për drejtësi dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Xhorxhtaun në Uashington, në Oksford të Londrës dhe Universitetin e Jelit në Nju-Hejven, Konektikat.



BILL KLINTON

Në vitin 1977 emërohet prokuror i përgjithshëm i shtetit të Arkansasit, ndërsa më 1978 u zgjodh guvernator i shtetit të Arkansasit, post që e mbajti deri në vitin

1992. Më 1992 dhe 1996, dy herë radhazi, fitoi zgjedhjet presidenciale, si kandidat i Partisë Demokratike. B. Klinton veptoi me vendosmëri kundër politikës luftënxitëse që ndoqi Jugosllavia nën regjimin e S. Millosheviqit, që nga mesi i viteve '90. Në vitin 1995, në bashkëpunim me NATO-n, ndërhyri për t'i dhënë fund luftës agresive të Beogradit në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në fillim të vitit 1999, B. Klinton luajti rol vendimtar në organizimin e veprimeve ushtarake të NATO-s në Jugosllavi. U angazhua që përmes operacioneve të Forcave Aleate t'i jep fund pastrimit etnik dhe gjenocidit serb mbi shqiptarët e Kosovës. Pas një fushate ushtarake prej 78 ditësh, më 10 qershor 1999, forcat ushtarake serbe u detyruan të tërhiqen nga Kosova dhe u krijuan kushtet për vendosjen e misionit paqësor të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), i cili vepronte në bazë të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Edhe pas largimit nga presidenca e SHBA-së, Klinton e përkrahu popullin dhe institucionet e Kosovës për ndërtimin e një shteti demokratik dhe të pavarur. Në shenjë mirënjohje për angazhimin e tij në dobi të pavarësisë së Kosovës, shumë rrugë e bulevarde janë emëruar me emrin e tij, kurse në Prishtinë i është ngritë shtatorja në bulevardin që mban emrin e tij, ndërsa Universiteti i Prishtinës i dha titullin Doctor Honoris Causa. (Naim Musliu)

KLUBET SHQIPTARE TË VITIT 1908.

Shoqëri kulturore dhe politike me synime patriotike të ngritura në qendra të ndryshme me banim të dendur shqiptarësh.

Klubi "Bashkimi" i Manastirit u formua më 31 korrik 1908 nga Feim Zavalani e Gjerasim Qiriazi. Qëllim kishte forcimin e unitetit kombëtar të shqiptarëve dhe përparimin e tyre kulturor, sidomos hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Klub nxori edhe gazetën e vet "Bashkimi i Kombit" e më vonë "Drita". Klubi luajti rol të rëndësishëm në formimin e klubeve të tjera kombëtare. Ishte ndër klubet më kontribuuese në Kongresin e Manastirit (1908) dhe në Kongresin e Elbasanit (1909). U mbyll nga xhonturqit në vitin 1910.

Klubi "Arsimor shqiptar" u themelua në Shkup në vitin 1908 nga Nexhpi Draga e Bajram Curri. Klubi u masivizua shumë shpejt me anëtarë të rinj. Klubi u angazhua në hapjen e shkollave shqipe dhe masivizimin e kulturës kombëtare. Si rezultat i aktiviteteve të tij u formua edhe

Klubi i Kumanovës, u hap shkolla shqipe në Pozhoran më 1909, një shkollë private në Gjilan dhe tjetra në Ferizaj. Klubi nxori gazetën "Shkupi". U godit nga reaksioni xhonturk, por anëtarët e klubit vazhduan veprimtarinë e tyre. Ata përkrahën dhe morën pjesë në kryengritjen e vitit 1910.

Klubi i Janinës, u themelua më 5 shtator 1908. Ishte ndër organizatat e para kombëtare që u formua pas fitores së Revolucionit Xhonturk. Kryetar i klubit ishte Zija Beu. Klubi i Janinës kishte statutin e vet me emrin "Rregullore e shoqërisë së shqiptarëve në Janinë" (1908), sipas të cilit qëllim kryesor kishte ngritjen kulturore dhe arsimore të popullsisë shqiptare në vilajetin e Janinës. Organi i Klubit të Janinës ishte gazeta "Zgjimi i Shqipërisë". Anëtarët e Klubit u ndoqën dhe u persekutuan nga qeveria xhonturke.

Klubi i Selaniku u formua në vitin 1908 në Selanik, me Mithat Frashërin, kurse nënkryetar ishte Arif Hiqmetin. Klubi kishte statutin e tij dhe nxori gazetën "Liria" si organ të tij. Në gazetë botoheshin artikuj kryesisht me përmbajtje arsimore dhe kulturore. Anëtarët e Klubit morën pjesë në aktivitete kombëtare, si në Kongresin e Manastirit (1908) dhe në Kongresin e Elbasanit (1909). (Frasher Demaj)

KLUBI I BASKETBOLLIT "BASHKIMI", PRIZREN.

U themelua në vitin 1945 me emrin "Metohija". Klubi kishte ekipin e meshkujve dhe të femrave. Në periudhën 1979-1985 zhvilloi gara në ligën e Kosovës dhe në ligën ndërrepublikane. Në sezonet 1985/86 dhe 1986/87 zhvilloi gara në ligën e parë B të ish-Jugosllavisë (Serbia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova). Në vitin 1986 u plasua në gjysmëfinale të Kupës së Jugosllavisë, bashkë me KB "Olimpija", KB "Shibenka" dhe KB "Bosnja". Garat gjysmëfinale dhe finale u mbajtën në Prizren në shtator të vitit 1986. Fitues ishte KB "Olimpija". Në këtë kohë KB "Bashkimi" zhvilloi në Prizren edhe një lojë revyale me KB "Cërvena Zvezda" të Beogradit dhe një ndeshje ndërkombëtare me KB "Fenerbahçe" të Stambollit, si dhe me përfaqësuesen e Shqipërisë, në të cilat ka triumfuar. Nga viti 1991 zhvilloi gara në sportin e pavarur të Kosovës. Pas luftës është anëtar në Superligën e Kosovës. Është fitues i Kupës së Kosovës dhe pjesëmarrës në ndeshjet përfundimtare për titull dhe Kupë të Kosovës. (Vllaznim Bytyçi)

KLUBI I BASKETBOLLIT “DRITA”, GJILAN. Pasardhës i ish-klubit të dikurshëm Klubi i hendbollit (KB) “Mlladost”, i themeluar në vitin 1956. Pas pavarësimit të sportit kosovar, klubi pagëzohet KB “Drita”. Suksesi më të madh e arriti në vitin 1996, kur u shpall kampion i Kosovës në basketboll. Në vitin 2002, për herë të parë në KB “Drita” u sollën lojtarë edhe nga jashtë vendit. Klubi edhe më tej e vazhdon aktivitetin, duke qenë anëtar i Superligës së Kosovës në basketboll. Klubi garon edhe në kategorinë e femrave, të cilat gjithashtu janë anëtare në ligën elitare të basketbollit kosovar. (Enver Sadiku)

KLUBI I BASKETBOLLIT “PRISHTINA”. Nis në vitin në vitin 1948, me emrin “Proleter”, i cili u themelua me iniciativën e profesor Bardhyl Zajmit, me ekip të meshkujve dhe femrave.



NJË NDESHJE BASKETBOLLI

Klubi ndërron emrin disa herë: “Jedinstvo”, “Bashkimi” dhe në fund “Prishtina”, ashtu siç e ka edhe sot. KB “Prishtina” garoi në ligën e atëhershme të Serbisë deri në vitin 1972. Në vitin 1979, me kërkesë të strukturave të atëhershme shoqërore-politike, bëhet fuzionimi ndërmjet “Elektrokosovës” dhe “Prishtinës” dhe klubi merr emrin KB “Prishtina”. Në stinorin 1986/87 bëhet kampione e Kosovës dhe së bashku me “Bashkimin” e Prizrenit bënë gara në ligën e parë B federative. Të dy ekipet zunë vendet e fundit dhe u larguan nga liga. Në mungesë të

mjeteve materiale, Prishtina u tërhoq nga garat në janar të vitit 1987, pa mbaruar kampionati. Gjatë kësaj kohe, në klub kanë parakaluar shumë basketbollistë të mirënjohur, si: Ferid Zekolli, Blerim Vuniqi, Zyfer Avdia, Ibrahim Karabegu, Vllaznim Perani, kurse për një periudhë trajner ishte Bardhyl Nushi. Pas pavarësimit të basketbollit të Kosovës, Prishtina arriti që dhjetë herë ta fitojë titullin e kampionit të Kosovës, kurse 11 herë edhe Kupën e Kosovës. Konsiderohet si skuadra më me shumë trofe të basketbollit kosovar. Në vitin 2015 fitoi edhe Ligën Ballkanike. (Edmond Thaçi)

KLUBI I BASKETBOLLIT “TREPÇA”. U themelua në Mitrovicë në vitet 1956-1958. Shumicën e lojtarëve e përbënin basketbollistë serbë deri në vitin 1984. Mori pjesë në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë. Ishte njëri nga pesë ekipet më të forta të Kosovës. Deri në vitin 1990 ishte fituese e shumë kupave të Kosovës dhe pjesëmarrëse në turne kualifikuese për finale të Kupës së Jugosllavisë. Në periudhën 1990-1998 fitoi dy tituj të kampionit dhe një herë trofeun e Kupës së Kosovës. Pas luftës ishte disa herë kampion i Kosovës dhe fitues i Kupës. Në vitin 2012 bëri një prezantim të suksesshëm në turneun ndërkombëtar në Bursa të Turqisë, me pjesëmarrje të shumë ekipeve të mëdha turke dhe europiane. Lojtarët më të mirë në kohën e ish-Jugosllavisë ishin Ferid Zekolli, Branislav Radibratoviq, Naim Hajrizi (deri në vitin 1989). Në kohën e pavarësimit të sportit, lojtarët më të dalluar ishin: Naim Hajrizi, Besim Braha, Eroll Pepiqi dhe Artan Mehmeti. Pas luftës në “Trepçë” janë angazhuar edhe një numër lojtarësh të huaj. (Edmond Thaçi)

KLUBI I BASKETBOLLIT “UNIVERSITETI” (FEMRAT). U themelua në vitin 1968, në Prishtinë. Në vitin 1973 “Universitetit” u bë kampion i Kosovës, duke i fituar të gjitha ndeshjet. Në sezonin 1975/76 “Universiteti” inkuadrohet në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Një vit më vonë, zuri vendin e katërt në ligën e parë federative, grupi i jugut, ndërsa në edicionin e radhës zuri vendin e tretë. Në vitin 1978 u formua liga unike. Në kampionatin 1980/81, “Universiteti” zuri vendin e shtatë, një vit më vonë vendin e tetë, kurse në kampionatin 1982/83 i nënti. U largua nga liga e parë e ish-Jugosllavisë në sezonin 1983/84 dhe vazhdoi garat në ligën e dytë,



KLUBI I BASKETBOLLIT "UNIVERSITETI"
(FEMRAT)

grupi lindor. Në kampionatin 1986/87 u bë kampion i grupit lindor të ligës së dytë dhe fitoi të drejtën e kualifikimeve për ligën e parë. Më 1987 "Universitetit" arriti të rikthehet në Ligën e parë. Trajnere ishte Resmije Juniku, zv/trajner Fatos Shita, ndërsa ngjyrat e klubit i mbrojtën: Resmije Juniku, Xhevahire Mustafa, Shemsije Stublla, Serbeze Perani, Xhemile Berisha, Dafina Rudi, Sabide Noshaj, Lëndita Sahatçija, Snezhana Saviq, Snezhana Jankoviq, Mirsada Zylfiu dhe Milla Çuriq. Trajner i skudarës ishte edhe Agim Kasapollu dhe Ismet Kurteshi. Pas largimit të sportistëve të Kosovës nga objektet sportive në vitin 1990, klubet e femrave ndalën aktivitetet. Me 1995 u aktivizuan disa klube, ndër to edhe Prishtina, që prej vitit 1998 sërish u quajt "Universiteti". (Edmond Thaçi)

KLUBI I BASKETBOLLIT "VËLLAZNIMI", GJAKOVË. U themelua në vitin 1954. Në fillim luhej në oborrin e Shkollës së Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" dhe më vonë në gjimnazin "Hajdar Dushi". Por KB "Vëllaznimi" u konsolidua më vonë, në vitet '80 dhe '90 të shekullit të kaluar, atëherë kur skuadra mori pjesë tri herë në ligën e parë B të ish-Jugosllavisë, si rezultat i shpalljes kampion i Kosovës. KB "Vëllaznimi" ishte kampion i Kosovës tri herë në stinorët 1980/81, 1981/82 e 1991/92, ndërsa ishte fitues i Kupës së Kosovës po ashtu tri herë në vitet 1992, 1995 e 1996. KB "Vëllaznimi" ishte edhe fituesi i parë i Kupës së Kosovës pas pavarësimit të basketbollit kosovar në vitin 1992. Legjendë e klubit konsiderohet Vëllaznim Rraci, i cili ka rekord paraqitjesh me "Vëllaznimin" gjatë karrierës mbi 20-vjeçare te ky klub. Në Gjakovë vepron edhe klubi i femrave me të njëjtin emër. (Moral Pozhegu)

KLUBI I BOKSIT "DRITA", GJILAN. Është pasardhës i klubit të boksit "Partizani", i formuar në vitin 1973. Në vitin 1984, KB "Partizani", pasi u bë kampion në ligën e Kosovës, bëhet pjesë e ligës së dytë të ish-Jugosllavisë. Më 1992 klubi pagëzohet me emrin "Drita" dhe me këtë emër vepron edhe aktualisht. Disa nga boksierët e "Dritës" janë të përfshirë edhe në përfaqësuesen e Kosovës. Në KB "Drita" bëhen gara edhe në boksing femëror. Klubi është organizator i dy turneve ndërkombëtare tradicionale të boksit, "Agim Rashiti" dhe "Shemsi Kurtalani". (Enver Sadiku)

KLUBI I BOKSIT "PRISHTINA". Boksi ishte sporti që më së shumti i solli suksese e medalje Kosovës. Rezultatet më të mira i solli KB "Prishtina", i cili deri në vitin 1976



ISH-BOKSIERËT E KLUBIT "PRISHTINA"

veproi me emrin "Radniçki". I themeluar në vitin 1949, klubi i Prishtinës fitoi pesë tituj të kampionit të ish-Jugosllavisë, gjashtë herë zuri vendin e dytë dhe tri herë të tretin. Të gjitha këto suksese lidhen me emrin e trajnerit Lah Nimani. Sukseset e klubit nisën që nga edicioni 1974/75, kur u fitua titulli i parë me brezin e boksierëve të njohur: Sahit Ajdini, Haki Peci, Zoran Dediq, Miodrag Gjorgjeviq, Shefki Bogujevci, Mujo Rashiti, Daut Dauti, Bajram Hashani, Faruk Gërxhaliu, Predrag Jovanoviq, Nazif Gashi, Enver Hajredini, Xheko Muhoviq dhe Xhevdet Peci. Këtij grupi boksierësh iu bashkuan më vonë edhe Sami Buzolli, Afrim Majanci, Haki Gashi, Nysret Rexhepi, Naser Bajrami, Zijadin Rama, Beqir Berisha, Aziz Salihu, Fatmir Makolli, Ismet Haziri, Muharrem Gjocaj, Agim Latifi, Abedin Lika, Skënder Hajdini etj. Sa herë që "Prishtina" ka boksuar qoftë në Kosovë, qoftë jashtë saj,

pallatet e sportit kanë qenë përplot shikues. Mbahen mend animet e adhuruesve të saj në Pallatin e sportit “1 Tetori”, numri i të cilëve arrinte në 6,000 shikues. Madje, kur “Prishtina” nisi të boksonte në Pallatin e Sportit, në tribuna dhe përreth ringut numri i shikuesve arrinte deri në 10,000 veta. (Lulzim Shala)

KLUBI I FUTBOLLIT “BESA”, PEJË. Është pararendëse e shumë skuadrave të futbollit në Pejë. U themelua në vitin 1974, në një periudhë kur lindën edhe klube të tjera të futbollit në Pejë, kryesisht me mbështetje të ndërmarrjeve prodhuese të qytetit. Në shtator të vitit 1991, me pjesëmarrjen e 38 përfaqësuesve të tri skuadrave të Pejës (“Buduqnosti”, “Besa” dhe “Kristali”) u mor vendimi që këto tri skuadra të bashkohen në një skuadër të vetme me emrin “Besa”. Kryetar u zgjodh Fuat Kryeziu, zëvendëskryetar Aziz Zeka dhe Bakir Burri, sekretar Muharrem Muhaxheri. Drejtuesit e skuadrës vendosën gjithashtu që t’i zhvillonin garat që do të organizoheshin nga Shoqata e Pavarur e Futbollit të Kosovës, që më pas u quajt Federata e Futbollit të Kosovës. Gjatë periudhës 1999-2015 “Besa” u shndërrua në njëri prej skuadrave më cilësore të Kosovës, duke qenë vazhdimisht në mesin e konkurruesve për tituj e trofe. Është kampione e Kosovës për kampionatet në stinorët 2004/05, 2005/06 dhe 2006/07, fituese e Kupës së Kosovës për edicionin 2004/05 dhe 2010/11, si dhe e Superkupës 2004/05. (Rifat Gjonbalaj)

KLUBI I FUTBOLLIT “CËRVENA ZVEZDA”, GJILAN. U themelua në vitin 1945. Për shumë vjet lojtarët shqiptarë në këtë klub ishin të rrallë. Në fillim garoi në ligën e parë të Kosovës, kurse kampion për herë të parë u shpall në vitin 1962/63 dhe më vonë, në vitin 1984/85, kur u bë edhe anëtar i ligës së dytë federative të ish-Jugosllavisë. Për disa vjet ka qenë një ndër klubet më të mira të Kosovës. Klubi sërish u braktis nga lojtarët shqiptarë në kohën kur Kosovës po i merrej autonomia. Ata iu bashkuan klubit tjetër nga qyteti i Gjilanit, KF “Drita”, që garonte në sistemin e mëvetësishëm të sportit kosovar. KF “Cërvena Zvezda” vazhdoi garat vetëm me lojtarë serbë dhe së fundi u shua. (Enver Sadiku)

KLUBI I FUTBOLLIT “DEVA”. U themelua në vitin 1958 nga disa entuziastë të futbollit.

Ata morën përkrahjen e ndërmarrjes “Deva”, sipas së cilës klubi mori edhe emrin. Klubi arriti të grumbullonte lojtarë të rinj dhe me perspektivë. Pas tri vitesh e ndërroi emrin, duke u emëruar KF “Gjakova”, emër që e mban edhe tash që nga viti 1961. KF “Gjakova” mbeti rekrutues i vazhdueshëm i talentëve të rinj të futbollit në qytetin e Gjakovës. (Moral Pozhegu)

KLUBI I FUTBOLLIT “DRITA”, GJILAN. Një ndër klubet më të njohura në futbollin kosovar. U formua në vitin 1947 nga një grup i të rinjve gjilanas. Fillimisht quhej Shoqëria Kulturore-Artistike e Sportive “Drita”. Prej vitit 1947 deri më 1952, KF “Drita” bënte pjesë në ligën e dytë të Kosovës. Pushteti i atëhershëm nuk e kishte në sy të mirë klubin, kështu që shumë lojtarë e drejtues të klubit u dënuan, disa u larguan nga puna dhe disa të tjerë u shpërngulën për në Turqi, kurse aktiviteti i ekipit u shua. Më 1977 klubi u riorganizua dhe nisi garat në ligën ndërkomunale dhe pas një viti kthehet në ligën e dytë të Kosovës. KF “Drita” nuk e ndërpreu aktivitetin as në vitin 1991. Pas luftës u bë njëri ndër ekipet më të mirë në Kosovë. Në vitin 2001 u shpall fituese e Kupës së Kosovës në futboll, derisa dy vite më pas, më 2003, bëhet kampion i Kosovës. Vazhdon të jetë anëtare e Superligës së Kosovës në futboll. (Enver Sadiku)

KLUBI I FUTBOLLIT “GJAKOVA”. U themelua në vitin 1961, pasi KF “Deva”, i themeluar në vitin 1958 u riemërua me këtë emër. KF “Gjakova” garoi kryesisht në kategorinë e dytë në futbollin kosovar. Megjithatë, ky klub mbeti rekrutues i vazhdueshëm i talentëve të rinj të futbollit në qytetin e Gjakovës. Nga radhët e tij dolën futbollistë të njohur të qytetit të Gjakovës, të cilët më vonë përfshiheshin në KF “Vëllaznimi”, si: Aziz Brahushi-Xixa, Hamdi Nuqi, Genc Lleshi, Faton Cërmjani, Sami Bunjaku etj. Suksesin më të madh KF “Gjakova” e arriti në vitin 2013, ku të rinjtë e këtij klubi U-12, e fituan turneun prestigjioz botëror, “Gothia Cup”, që mbahet çdo vit në Suedi. (Moral Pozhegu)

KLUBI I FUTBOLLIT “GJILANI”, GJILAN. U themelua në vitin 1995. Fillimisht u quajt me emrin “Gjilani ’95” dhe për një kohë të shkurtër ia arriti të bëhet ekip futbollit me emër.

Suksesin më të madh e arriti në vitin 2000, duke u bërë fitues i Kupës dhe Superkupës së Kosovës, kurse gjatë periudhës dhjetëvjeçare, dy herë qe nënkampion i Kosovës dhe dy herë të tjera finalist i kupës. Bashkë me klubin e futbollit "Drita" nga Gjilani, kur ballafaqohen ndërmjet vetes zhvillojnë kryendeshjen më të njohur e më të nxehtë në Kosovë, e cila në stadiumin e qytetit mbledh me dhjetëra mijëra shikues. Është anëtar i ligës së parë të Kosovës. (Enver Sadiku)

KLUBI I FUTBOLLIT "KORABI", DIBËR.

Në Dibër futboli i organizuar nis të luhet pas Luftës së Dytë Botërore. Skuadra merr emrin "Korabi" dhe luante miqësore me skuadrat e Strugës, Ohrit, Resnjës dhe veçanërisht Peshkopisë. Klubin e futbollit "Korabi" për herë të parë e gjejmë të garojë në një ligë rajonale në vitin 1947. Në vitin 1950 skuadra bëri gara në ligën e Gostivarit, pastaj në atë të Tetovës (1951/52), dy vjet në ligën e Shkupit dhe për shumë vjet në Ligën ndërrepublikane të Manastirit, deri më 1965. Gjatë periudhës 1966-1969 "Korabi" sërish bën gara në ligën rajonale të Tetovës. Në vitin 1976 u themelua Liga komunale dhe që në vitin e parë KF "Korabi" fitoi të drejtën për ndeshje kualifikuese për një rang më të lartë të garave. Në stinorin 1986/87 "Korabin" e hasim në ligën rajonale deri më 1991. Pas dy stinorëve të kaluar në ligën rajonale, me ndarjen e ligës së dytë në dy liga, "Korabi" fitoi të drejtën për të bërë gara në Ligën e dytë të Maqedonisë, ku garoi për tre vjet rresht. Në kampionatin 1998/99 skuadra humbi statusin e anëtarit të ligës së dytë dhe skuadra u përfshi në vështirësi që e ndoqën për dhjetë vjet. Në kampionatin 2010/11, me ndihmën e tifozëve "Sokolat", skuadra zuri të këndellej dhe të bëjë gara në ligën e dytë të Maqedonisë. (Edmond Thaçi)

KLUBI I FUTBOLLIT "LIRIA", PRIZREN.

U themelua në vitin 1930. Fillimisht klubi u organizua nga zejtarët, përkatësisht esnafët prizrenas, me emrin "Gajret". Para Luftës së Dytë Botërore zhvilloi gara në ligat më të ulëta jugosllave. Deri në vitin 1970 klubi quhej "Metohija", pastaj u ripagëzua në KF "Liria". Në vitet '70 dhe '80 "Liria" ishte pjesë e ligës së dytë dhe e ligës së parë B të ish-Jugosllavisë. Më 1988 arriti deri në gjysmëfinale të Kupës së



KLUBI I FUTBOLLIT "LIRIA", PRIZREN

ish-Jugosllavisë, duke fituar paraprakisht kundër skuadrave, si "Radnički" i Nishit dhe "Hajduku" i Splitit. Në gjysmëfinale mënjanohej nga "Velezhi" i Mostarit. Pas pavarësimit të sportit të Kosovës, "Liria" e zhvilloi ndeshjen e parë me "Ballkanin" e Studençanit (1991), ku shënoi golin e parë për futbollin e pavarur kosovar. Në vitin 1995 shpallet kampione e Kosovës dhe zhvillon gara deri në vitin 1998. Pas luftës "Liria" vazhdoi garat në stadiumin e saj, që mban emrin e dëshmorit, ish-futbollistit, Përparim Thaçi. Liria dy herë fitoi Kupën e Kosovës (2006/07 dhe 2009/10). (Vllaznim Bytyçi)

KLUBI I FUTBOLLIT "PRISHTINA". E ka zanafillën në vitin 1922, nga një ekip futbollit që u themelua nga ushtarët e garnizonit të Prishtinës. Pas Luftës së Dytë Botërore, në



KLUBI I FUTBOLLIT "PRISHTINA"

periudha të ndryshme, ishte skuadra që ndikoi më së shumti në rrjedhat e futbollit në Kosovë. Ngjitjen e nisi si nënkampione e ligës së dytë qendrore të ish-Jugosllavisë, duke marrë pjesë në kualifikime për ligën e parë federa-

tive (1971/72). Edhe në stinorin vijues doli nën-kampione dhe mori pjesë në kualifikime, por nuk ia doli të bëhej pjesë e elitës së futbollit jugosllav. Trajneri hungarez i Vojvodinës, Bella Palfi, i cili e udhëhoqi "Prishtinën" nga viti 1981-1983 ka meritat më të mëdha për kualifikimin e skuadrës në elitën e futbollit të ish-Jugosllavisë. Për shkak të rrethanave politike në Kosovë, në vitin 1981 skuadra u detyrua që tërë stinorin pranveror ta zhvillojë jashtë Kosovës për shkak të ndalimit të aktiviteteve sportive në Kosovë. Në edicionin 1982/83 "Prishtina" u kualifikua në elitën e futbollit të ish-Jugosllavisë dhe për pesë vite (deri më 1988) ishte pjesë e kësaj lige. Viti i fundit i "Prishtinës" në futbollin e ish-Jugosllavisë ishte edicioni 1990/91, kur Kosova ishte e pushtuar, uzurpohet edhe stadiumi, ndërsa nga skuadra u larguan pothuajse të gjithë futbollistët shqiptarë. Skuadra sërisht rithemelon kryesinë dhe në rrethana të jashtëzakonshme i vazhdon garat në fushat në periferi të qytetit (në lagjen "Arbëria", në stadiumin e "Flamurtarit", në fshatin Llukar etj.). Gjatë kësaj periudhe "Prishtina" fitoi tre tituj kampioni, dy Kupa të Republikës së Kosovës dhe dy Superkupa të Kosovës. Pas përfundimit të luftës (pas tetë vjetësh dëbimi) kthehet në stadiumin e saj. Gjatë kësaj periudhe "Prishtina" i fitoi shtatë tituj kampioni, dy Kupa të Republikës së Kosovës dhe gjashtë Superkupa të Kosovës. KF "Prishtina" bën gara në kategorinë më të lartë të futbollit në Kosovë (në Superligë) dhe konsiderohet skuadra më e suksesshme në historinë e futbollit të Kosovës. (Ejup Llumnica)

KLUBI I FUTBOLLIT "RENOVA", XHEPÇISHT, MAQEDONI. Skuadra u themelua në vitin 2003, fillimisht si shkollë e futbollit, ndërsa më vonë u formua skuadra e seniorëve. Pas bashkimit me KF "Shkumbini" të Tetovës, skuadra mori emrin "Renova", që një kohë bëri gara në ligën e tretë të Maqedonisë. Skuadra me emër të ri u kualifikua në ligën e dytë (2003/04), ndërsa në edicionin 2004/05 fitoi të drejtën e kualifikimit në elitën e futbollit të Maqedonisë. Në edicionin 2008/09 "Renova" mori pjesë në garat e kupave europiane, madje kaloi rrethin e parë të ligës së Europës, pasi mënjanoi "Rijekën" e Kroacisë. Edicioni 2009/10 ishte më i suksesshmi: "Renova" u shpall kampione e Maqedonisë. Në edicionin 2010/11 "Renova" mori pjesë në garat e ligës

së kampionëve të Europës, por u mund që në rrethin e parë të eliminimeve. (Xhavit Kajtazi)

KLUBI I FUTBOLLIT "SHKËNDIJA". U themelua në vitin 1979 në Tetovë me iniciativën e të rinjve shqiptarë. Duke filluar nga liga më e ulët në ish-Jugosllavi, "Shkëndija" arriti ta fitojë



KLUBI I FUTBOLLIT "SHKËNDIJA", TETOVË

ligën lokale në stinorin 1979/80, që i mundësoi ngjitjen në ligën e tretë. Në stinorin vijues "Shkëndija" u ngjit në ligën e dytë. Me rritjen e popullaritetit të klubit mes shqiptarëve të Maqedonisë, regjimi i atëhershëm e shoi klubin për shkaqe politike. Pas shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë, "Shkëndija" u rithemelua dhe rinisi garat në ligën e futbollit të Maqedonisë. Filloi me ndeshje në ligën e katërt, për t'u ngjitur hap pas hapi, në secilin stinor, deri në ligën e parë të Maqedonisë. Në stinorin 2010/11 klubi arriti të shpallet kampion i ligës së parë të Maqedonisë në një seri prej 16 ndeshjesh pa u mposhtur në asnjërën. (Ejup Llumnica)

KLUBI I FUTBOLLIT "TËRNOCI". U themelua në vitin 1976 nga disa të rinj, të cilët asokohe studionin në Universitetin e Prishtinës. Gjatë edicionit 1976/77 dhe 1978/79, nga liga komunale kalon në dy kategori më lart. Mirëpo, mungesa e fushës së futbollit bëri që klubi ta pushojë veprimtarinë (1979). Nga të njëjtët nismëtarë, "Tërnoci" riaktivizohet në vitin 1983, ndërsa në vitin 1984 ndërtohet stadiumi i këtij klubi. Periudha 1983-1987 ishte më e suksesshme në historikun e skuadrës. "Tërnoci" kalon në ligën rajonale. Periudha më e vështirë e skuadrës ka qenë ajo e viteve 1989-1991, kur në mungesë të mjeteve materiale u detyrua të tërhiqet nga garat. Por nuk e pushoi

veprimtarinë, sepse nga ky vit filloi organizimi i ndeshjeve miqësore me ekipet nga Kosova. Veçohet sidomos takimi i zhvilluar më 1992 në Tiranë, midis "Partizanit" të Tiranës dhe "Tërnocit". KF "Tërnoci" ishte skuadra e parë që zhvilloi një takim të këtillë me ndonjë skuadër nga Shqipëria. Ndërkohë arrin që të kualifikohet në ligën e dytë të Kosovës. Pas luftës rifilloi garat me sukses në ligën rajonale. (Xhavit Kajtazi)

KLUBI I FUTBOLLIT "TREPÇA". U themelua në Mitrovicë në vitin 1932. Te kjo skuadër kanë luajtur dhe janë formuar shumë futbollistë shqiptarë, të cilët bënë emër jo vetëm në



KLUBI I FUTBOLLIT "TREPÇA", MITROVICË

futbollin e ish-Jugosllavisë, por edhe në Europë. Suksesi i parë i "Trepçës", erdhi në edicionin 1976-1977, kur fitoi titullin e kampionit të Ligës së dytë federative të Jugosllavisë. Në edicionin e ardhshëm, "Trepça" luajti në Ligën e parë federative dhe arriti në finale të Kupës së Jugosllavisë, ku u mposht nga skuadra e "Rijekës" me rezultatin 1:0 pas vazhdimeve. Skuadra nga Mitrovica në edicionin 1977/78 ka luajtur edhe ndeshje ndërkombëtare kundër "Real Zaragozas" në Spanjë, pastaj kundër "Slivenit" të Bullgarisë dhe kundër "Tiranës" nga Shqipëria. Suksesin në futboll kjo skuadër e arrin edhe në vitet e para pas luftës në Kosovë. Në edicionin 1993/94, kur sporti i Kosovës ishte pavarësuar, "Trepça" u shpall kampion. Titullin e kampionit të elitës së futbollit kosovar e ka fituar edhe në edicionin 2010/11. Krahas titullit, ka fituar edhe Kupën e Republikës së Kosovës. (Arsim Maxhera)

KLUBI I FUTBOLLIT "VËLLAZNIMI", GJAKOVË. U themelua në vitin 1927 nga



KLUBI I FUTBOLLIT "VËLLAZNIMI", GJAKOVË

Faik Dushi, i cili kishte sjellë topa nga Kroacia. Në atë kohë quhej "Shpata e Kosovës", më pas u quajt "Pashtriku", "Ylli i kuq" dhe në fund, "Vëllaznimi", emër që e mban edhe sot. Është njëri prej klubeve më të suksesshme në futbollin kosovar. Pjesë e kësaj historie ishte kapiteni Ahmet Zajmi-Gala, i cili gëzonte respekt jo vetëm nga bashkëlojtarët, por edhe nga adhuruesit e shumtë të klubit. "Kuqezinjët", siç njihen në zhargonin sportiv, që nga sezoni 1967/68 dhe deri më 1989/90, janë shpallur nëntë herë kampionë të Kosovës, duke qenë klubi i dytë më i suksesshëm në vend, pas KF "Prishtina". Pas luftës së fundit nuk arriti të shpallej kampion asnjëherë, por një herë fitoi Kupën e Kosovës në stinorin 2007/08. Por këtë trofe e fitoi edhe katër herë më parë, kryesisht gjatë viteve '80 të shekullit të kaluar. "Vëllaznimi" ka nxjerrë lojtarë të njohur, si: Besnik Hasi, Ardian Kozniku, Faton Domi, Genc Hoxha etj. (Moral Pozhegu)

KLUBI I FUTBOLLIT KNI "RAMIZ SADIKU". Skuadra e dytë më e suksesshme e futbollit në Prishtinë, pas KF "Prishtina", e themeluar në vitin 1975 nga ish-Kombinati ndërtimor industrial "Ramiz Sadiku". Një kohë ishte edhe pjesë e rangut të lartë të garave të ish-Jugosllavisë, në ligën e dytë qendrore. Nga paslufta (1999) e deri në vitin 2015 bëri gara që nga liga e dytë e deri te liga e parë e Kosovës. Që nga viti 2005, KNI "Ramiz Sadiku" u shndërrua në skuadër të qëndrueshme, duke shtrirë veprimtarinë me shkollën e futbollit, por edhe me skuadrat e grupmoshave të reja. (Ejup Llumnica)

KLUBI I HENDBOLLIT "BORCI", FERIZAJ. U themelua në vitin 1957. Po këtë vit i nisi

garat në ligën e atëhershme krahinore, të cilat u detyra t'i braktisë për mungesë të mjeteve financiare. Skuadra i rifilloi garat në vitin 1960/61. Në vitin 1962/63, në krye të skuadrës erdhi Hysni Firza, i cili ka meritat kryesore për ngritjen e “Borcit” ndër klubet më të njohura në ish-Jugosllavi dhe në Europë. Katër herë u kualifikua në elitën e hendbollit të ish-Jugosllavisë (luajti në edicionet 1975/76, 1978/79, 1979/80, 1982/83, 1986/87, 1987/88 dhe 1988/89), ndërsa në garat e ligës së dytë qendrore gjithnjë ka qenë në krye të renditjes. Suksesin më të madh ferizajasit e arritën në vitin 1979, kur luajtën në finale të Kupës së ish-Jugosllavisë, duke humbur nga Borci i Banjallukës. Pas vitit 1991 skuadra mori emrin “Kastrioti”. (Florim Maliqaj)

KLUBI I HENDBOLLIT “BOZHURI”, GILAN. Klubi u formua në vitin 1958 me emrin “Partizani”. Në vitin 1962 zhvilloi ndeshje ndërkombëtare me ekipin “Taufik” nga Egjipti. Në fillim të kampionatit 1966/67 ekipi pagëzohet me emrin “Bozhuri”, duke marrë mbështetjen e Fabrikës së Duhanit, e cila prodhonte cigare me këtë emër. Në fund të viteve ‘60 dhe në fillim të viteve ‘70 KH “Bozhuri” mori katër herë epitetin e kampionit të Kosovës. Në vitin 1974 bëhet anëtar i Ligës së dytë federative të ish-Jugosllavisë. Në vitet vijuese bëhet kampion dhe fiton Kupën e Kosovës. Zhvillimet politike në fund të viteve ‘80 dhe në fillim të viteve ‘90 prekën edhe këtë ekip. Atë kohë “Bozhurit” iu ndërrua emri në KH “Jugoterm”. Gjatë viteve ‘90 lojtarët shqiptarë, të përzënë nga palestrat, vazhduan garat në vende të ndryshme. Në vitin 1991 klubi u pagëzua me emrin KH “Drita”. (Enver Sadiku)

KLUBI I HENDBOLLIT “DRITA”, GJILAN. Para se të pagëzohej me këtë emër në vitin 1991, veprimtarët me emrin Klubi i hendbollit (KH) “Bozhur”. Gjatë viteve ‘90, KH “Drita” mori barrën edhe të qyteteve të tjera, duke qenë organizues i të gjitha garave me rëndësi në Kosovë. Edhe pas luftës KH “Drita” vazhdoi të jetë anëtar i ligës së parë të Kosovës. Që nga viti 1960, në Gjilan ka zënë fill edhe hendbolli femëror. Pas lufte, në kategorinë e femrave, KH “Drita” ishte pjesëmarrëse e dy finaleve. Edhe klubi i femrave e vazhdon veprimtarinë në ligën e parë të Kosovës. (Enver Sadiku)

KLUBI I HENDBOLLIT “TREPÇA”. U themelua në Mitrovicë në vitin 1950. Në edicionin 1974/75 inkuadrohet në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. Pas pesë edicioneve në ligën e dytë, skuadra e hendbollit “Trepça” shpallet kampion në edicionin 1979/80, për të fituar të drejtën që në edicionin 1980/81 të garojë në ligën e parë federative të ish-Jugosllavisë. Më i merituari për këto arritje ishte trajneri Sami Mustafa, kurse prej hendbollistëve u veçuan Ferki Nici dhe Aziz Makiqi. Pas pavarësimit të sportit, në edicionin 1991/92 “Trepça” merr pjesë në Ligën e Republikës së Kosovës. Suksesin më të madh gjatë kohës së okupimit kjo skuadër e arrin në edicionin 1993/94, kur krahas titullit të kampionit fiton edhe Kupën e Kosovës. Në edicionin 2001/02 shpallet kampion e Kosovës, kurse një edicion më vonë e fiton kupën, që llogariten ndër rezultatet më të mira të pasluftës. Në edicionin 2004/05, të drejtuar nga trajneri Taib Kabashi, skuadra arrin suksesin më të madh, pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare “Kupën sfiduese”. Mirëpo, Rusia nuk u dha viza hendbollistëve të “Trepçës”, duke i privuar nga pjesëmarrja në turneun kualifikues në qytetin Krasnodar. (Arsim Maxhera)

KLUBI I HENDBOLLIT “VËLLAZNIMI”, GJAKOVË. U themelua në vitin 1955. Ndër nismëtarë të klubit ishin: Ismajl Berisha, Shani Brahuhi, Qemajl Dylatahu, Bedri Zhubi, Sami Dana, Skënder Polloshka e Sami Bërdoniqi. Në vitet vijuese, në periudhën 1960-1979 KH “Vëllaznimi” mori gjashtë herë titullin e kampionit. Në stinorin 1977/78 KH “Vëllaznimi” mori pjesë në ligën e dytë të ish-Jugosllavisë, grupi i jugut, por për shkak rezultateve të dobëta u kthye në ligën e parë të Kosovës. Në klubin gjakovar kanë luajtur lojtarët, si: Dujaka, Nagavci, Haxhikadria etj. dhe profesor Ismajl Berisha, i cili, ndër të tjera, e ka publikuar edhe librin me titull “Hendbolli gjakovar 1955-2005”. Pas pavarësimit të sportit (1991), KH “Vëllaznimi” bëri gara në elitën e hendbollit të Kosovës. Skuadra vazhdoi të jetë pjesë e Superligës së Kosovës edhe gjatë periudhës 1999-2015. Krahas klubit të meshkujve, vepron edhe ai i femrave me të njëjtin emër. (Moral Pozhegu)

KLUBI I MUNDJES “LIRIA”, SHKUP. U themelua në vitin 1977, me nismën e Mentaz Allajbegut dhe të disa veprimtarëve të tjerë të

sportit, në kuadër të shkollës fillore “Liria” të Shkupit. Në të njëjtën kohë u themelua edhe klubi i boksit dhe i hendbollit. Kryetar i parë i klubit të mundjes ka qenë Ali Shehu, i cili ka kryesuar me klubin deri në vitin 1984. Deri në vitin 1991 bartësit kryesorë të sukseseve të “Lirisë” kanë qenë Shaban Tërstena, Shaban Sejdiu, Agim Ejupi, Ismet Feruku, Lutfi Xhelili, Ibrahim Rexhepi, Nexhat Ismaili, Sezair Shabani, Xhevat Fuga, Nusret Hamidi, Imer Kadriu, Sami Salihu, Sali Bela, Sabedin Fuga etj. Prej tyre rezultatin më të mirë e kanë arritur Shaban Tërstena dhe Shaban Sejdiu. Mundës të tjerë, të cilët kanë pasur arritje të mëdha botërore nga ky klub janë edhe Bajram Çorolli, kampion botëror për të rinj (Edmontoni i vitit 1980), si dhe Agim Ejupi (i treti i Europës për të rinj në vitin 1987). Nga brezi i ri duhet veçuar Lulzim Vrenezi dhe Fekri Memishi, ndërsa Elmedin Sejfullau për dy vjet me radhë fitoi medalje të bronzit në kampionatet europiane për kadetë. Pos tij, arritje tjetër të madhe për klubin ishte edhe e Jasin Rexhallarit, i cili në Lojërat e Mesdheut në Mersin të Turqisë fitoi medaljen e bronzit (2013). (Edmond Thaçi)

KLUBI I VOLEJBOLLIT “DRITA”, GJILAN.

Ekipi i parë i volejbollit në Gjilan u formua në vitin 1960 dhe mori emrin Klubi i volejbollit (KV) “Partizani”. Në vitin 1972/73 ekipi ripagëzohet me emrin “Akademiku”, ndërkohë punëtorët e Kombinatit të Tekstitit formojnë ekipin “Tekstilisti”. Në vitet vijuese u theksua rivaliteti ndërmjet “Akademikut” e “Tekstitit”, epike që garonin në ligën e parë të Kosovës. Bashkimi i këtyre ekipeve në një, që u quajt “Taftisoni”, sjell suksesin më të madh në vitin 1981/82, kur ky ekip shpallet kampion i Kosovës dhe garon me sukses në ligën e dytë federative të ish-Jugosllavisë. Pas pavarësimit të sportit kosovar, ekipi ndërron emrin në KV “Drita” dhe me këtë emër u shpall kampion në vitin 1988. Menjëherë pas luftës ekipi ishte edhe fitues i Kupës së Kosovës. Në vitet vijuese u shqua veçmas ekipi i femrave të KV “Drita”, kampion i gjashtëfishitë i Kosovës dhe fitues i njëpasnjëshëm i kupës. Volejboli i vajzave në Gjilan ishte ndër të parët që arriti të dilte në arenën ndërkombëtare të sportit, duke marrë pjesë në turneun në Danimarkë, në ballafaqim me ekipet më të mira të këtij vendi. Ekipi vazhdon aktivitetin në elitën e volejbollit kosovar. (Enver Sadiku)

KLUBI I VOLEJBOLLIT “SHKËNDIJA”, TETOVË. Volejboli në Tetovë ka qenë dhe vazhdon të jetë sport popullor. Në vitet ‘70 në rajonin e këtij qyteti kishte 37 skuadra të



KLUBI I VOLEJBOLLIT “SHKËNDIJA”, TETOVË

volejbollit. Pas 10 vjetësh ndalesë për Shoqatën sportive “Shkëndija”, ku bënte pjesë edhe klubi i volejbollit, në vitin 1991 u krijuan mundësi për rimëkëmbjen e jetës sportive të shqiptarëve në Maqedoni, kështu që në gusht të vitit 1991 u rithemelua KV “Shkëndija” për të dy gjinitë. Gjatë periudhës 1992-1999 skuadra iu përkushtua punës me të rinj. Që nga viti 2000, KV “Shkëndija” merr pjesë në garat e kupës së Europës. Në kampionatin 1992/93 edhe klubi i femrave “Shkëndija” fiton të drejtën që të luajë në garat e fituesve të Kupës së Europës. Në kampionatin e vitit 2010/11 “Shkëndija” u bë kampione dhe fituese e Kupës së Maqedonisë. Gjatë kësaj periudhe zuri vendin e tretë në Ligën Ballkanike, ndërsa fitoi edhe titullin e kampionit mbarëkombëtar, duke e mundur në finale “Studentin” e Tiranës. Pas vitit 2012 skuadrën e përfshijnë vështirësitë financiare, por edhe mungesa e lojtarëve cilësorë dhe për të dytën herë u tërhoq nga garat zyrtare të Ligës së Maqedonisë. (Edmond Thaçi)

KLLOKOQI Sylejman (1958-). Kameraman, mësimdhënës universitar. Lindi në Marec, komuna e Prishtinës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, ndërsa studimet për kamerë në Fakultetin e Arteve në Beograd. Është autor i librit universitar “Kamera”, doracak për studentë dhe për profesionistë të kamerës. Punoi si operator në Televizionin e Prishtinës, ku xhiron reportazhe e emisione të ndryshme. Më pas punoi për kanalin televiziv “Yu-Tel”, ku realizoi reportazhe, kronika,

intervista. Është operator i dhjetëra filmave dokumentarë të metrazhit të gjatë. Xhiron dramën televizive “Fluturimi i Micakut”. Ishte korrespondent-kameraman nga Prishtina i Agjencisë Rojters. Gjithashtu punoi si kameraman në Zagreb, Beograd dhe Sarajevë, ku për dy vjet ishte korrespondent-kameraman gjatë luftës. Bashkëpunoi me studiot televizive BBC, CNN, ABC etj. Së fundi punon për Agjencinë e lajmeve “Associated Press” (AP). Xhirimet e tij dokumentare të ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë, në rajon dhe më gjerë u transmetuan nga shumë qendra televizive botërore. Xhironi pamje ekskluzive të krimeve serbe në Kosovë. Për agjencinë AP xhironi masakrën e Reçakut, si dhe qindra tregime të luftës së Kosovës, të luftës në Maqedoni, Preshevë etj. Është mësimsdhënës i lëndës së kamerës dhe fotografisë në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. (Gani Mehmetaj)

KLLOKOTI. Vendbanim qendror me funksione administrative dhe qendër e komunës me të njëjtin emër. Nndodhet rreth 6 km në veri të Vitisë. Shtrihet në zonën e fushës së Moravës së



KLLOKOTI

Binçës, në lartësi mbidetare 479 m. Është një e rrugëve të rëndësishme rajonale dhe kombëtare. Klokoti ndodhet ndërmjet dy qendrave të rëndësishme, Gjilanit dhe Ferizajt, në largësi gati të të barabarta prej 16 km, ndërsa nga Vitia 6 km. Në vitin 2011, Klokoti kishte 1,064 banorë, ndaj 764 banorëve, sa kishte në vitin 1948. Popullsia merret me bujqësi, zejtarë, turizëm dhe tregti. Në hapësirën e këtij vendbanimi, ku ndodhet burimi termal, janë ndërtuar dy objekte hoteliere-shëndetësore “Stacioni i Vjetër Shëndetësor” dhe kompleksi rehabilitues shëndetësor “Nana Naile”. Ka shkollën fillore dhe atë të mesme të lartë në gjuhën shqipe dhe

serbe, kurse në dalje, përkatësisht në anën e majtë të rrugës Gjilan-Klokot-Ferizaj, ndodhet objekti i kishës ortodokse. Nga objektet e tjera të standardit shoqëror ka administratën komunale, qendrën e mjekësisë familjare, disa shërbime tregtare etj. (Nexhat H. Rexha)

KLLOKOTI (komuna). Komunë në Anamoravë, me sipërfaqe 23.4 km². Përfshin Klokotin dhe tri vendbanime përreth: Mogillën, Vërbovcin dhe Gernçarin. Statusin e komunës e fitoi zyrtarisht më 8 janar 2010, kur me ndarjen e re administrative të paraparë me Planin e Ahtisarit ndahet nga komuna e Vitisë. Ka pozitë të volitshme gjeografike, ngase përmes rrugëve automobilistike komuna e Klokotit lidhet me Gjilanin, Ferizajn dhe Vitinë. Komuna e Klokotit është një e rëndësishme e rrugëve me karakter kombëtar dhe ndërkombehtar. Territori i komunës së Klokotit i takon masivit kristalor të Rodopeve. Ajo shtrihet mes maleve të Karadakut (Malit të Zi) të Shkupit dhe maleve të Zhegovcit. Klima është e mesme kontinentale, nën ndikimin e erërave veriore, verilindore dhe perëndimore. Derisa në vitin 1948 jetonin 775 banorë, në vitin 2011 në komunën e re të Klokotit popullsia numëronte 2,556 banorë. Sipas përkatësisë etnike, popullsia është heterogjene, por shumicën e përbëjnë serbët. Veprimtaritë kryesore ekonomike janë: turizmi (dy komplekse rekreative shëndetësore të banjës), ambalazhimi i ujit mineral, lavërtaria, tregtia etj. Nga objektet e standardit shoqëror komuna ka institucionin e arsimit parashkollor, tri shkolla fillore, shkollën e mesme, disa njësi tregtare dhe shërbuese etj. (Nexhat H. Rexha)

KNI “RAMIZ SADIKU”, PRISHTINË. U themelua në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore për ndërtimin dhe rindërtimin e vendit. Në vitin 1950 merr emrin ndërmarrja ndërtimore krahinore “Ramiz Sadiku”. Në vitin 1956 filloi riorganizimi i ndërmarrjes, me themelimin e disa punishteve të vogla, përfshirë edhe punimet përfundimtare në ndërtimtari. Me këto ndryshime numri i punëtorëve arriti në rreth 1,500. Po në këtë kohë ndërmarrja filloi të pajiset me mjete të ndërtimtarisë dhe sektorë të rinj. Në vitet ’70 të shekullit të kaluar, me zhvillimin e infrastrukturës dhe ngritjen e shumë objekteve shoqërore në mbarë Kosovën, ndërmarrja ndërtimore “Ramiz Sadiku” arrin

zhvillim të shpejtë. Në kuadër të saj integrohen disa ndërmarrje më të vogla ndërtimore nga Ferizaj, Prizreni, Mitrovica, Peja, Prishtina etj. dhe ndërmarrja merr emrin Kombinati Ndërtimor Industrial (KNI) "Ramiz Sadiku", në kuadër të të cilës kishte 14 njësi punuese. Ishte njëri ndër kombinatet ndërtimore më të mëdhenj në ish-Jugosllavi, me 9,000 punëtorë, me mbi 750 automjete transportuese deri në 20 tonësh, me mbi 350 makina të rënda ndërtimore, me mbi 20 vinça për transport vertikal të materialit ndërtimor, tri autopompa, 20 automikserë për bartjen e betonit, tre autovinça për peshëngritje deri në 40 tonelata dhe autopeshoren deri në 50 tonë etj. KNI "Ramiz Sadiku" kreu të gjitha llojet e ndërtimeve, ndërtimet e larta dhe të ulëta, ndërtimet hidroteknike, ndërtimet e objekteve industriale etj. Ndërtoi mbi 40 fabrika të ndryshme në Kosovë dhe jashtë vendit, ndërtoi shumë objekte industriale, kompleksin e objekteve energjetike "Kosova A" dhe "Kosova B", pjesërisht "Ferronikelin" në Drenas, drithnikët në tërë Kosovën, hidrosistemin "Ibër-Lepenc", stabilimentet e flotacionit "Trepça", shumë objekte banimi në tërë Kosovën dhe jashtë saj, 18 ura në magjistralen Kosovë-Mal i Zi etj. Periudha më e suksesshme për këtë gjigant ndërtimor ishin vitet 1970-1980 kur investimet në Kosovë ishin më të mëdha. Pas viteve '90 ky kombinat u shpërbë në tërësi dhe disa asete të tij u privatizuan. (Fetah Jagxhiu).

KOALICIONI "VAKAT". Bashkimi i disa partive të komunitetit boshnjak në Kosovë. "Vakat" u themelua në qershor të vitit 2004, si koalicion i përbashkët i subjekteve politike boshnjake, me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave dhe interesave të pakicës boshnjake në Kosovë. Partitë politike themeluese të këtij koalicioni ishin: Partia Demokratike e Boshnjakëve, (Demokratska Stranka Bosnjaka-DSB); Partia Demokratike "Vatan" (Demokratska Stranka Vatan-DSV) dhe Partia e Boshnjakëve të Kosovës nga Prizreni, Sharri (Dragashi) dhe nga Peja; (Boshnjacka Partija Kosova-BSK). Në koalicionin "Vakat" bëjnë pjesë këto subjekte politike: DSB, DSV, USB dhe NSB. Koalicioni "Vakat" vazhdon të veprojë si një koalicion i qëndrueshëm politik i komunitetit boshnjak. (Mazllum Baraliu)

KOALICIONI DARDANO-ILIR. Marrëveshje ndërmjet shtetit dardan dhe të shtetit ilir,

pas fuqizimit të tyre, për t'i luftuar kundërshtarët e përbashkët. Nga mesi i shek. III p.e.r. dardanët u bënë populli më i fuqishëm në brendinë e Ballkanit dhe shteti ilir u fuqizua me mbretin Agron dhe Teutën. Maqedonia ishte e dobësuar nga sulmet e dardanëve nga veriu dhe të Lidhjes etole-akease nga jugu. Fuqizimi i shtetit ilir preku interesat e Dardanisë dhe kjo reagoi duke u ndihmuar fqinjëve, për ç'arsye komandantët morën letra nga Teuta që të ktheheshin sa më parë nga jugu, pasi një pjesë e ilirëve kishte kaluar në anën e dardanëve. Barazforca e dy shteteve dhe armiqtë e përbashkët bënë që të realizohej koalicioni dardano-ilir dhe t'u ndihmohej romakëve në ekspeditën kundër mbretit të Maqedonisë, Filipit V (201 p.e.r.). Mbreti i Dardanisë, Bato, dhe ai i Ilirisë, Pleurati, lidhën aleancë me romakët në llogorin e konsullit Galba (200 p.e.r.) dhe u bënë pjesë e koalicionit antimaqedon, si dhe morën pjesë në Luftën II romako-maqedonase. Koalicioni dardano-ilir u fuqizua me fejesën e Etutës, vajzës së mbretit dardan Monunit, me Platorin, trashëgimtarin e fronit ilir. Më pas martesë dinastike e Etutës u realizua me mbretin ilir, Gentin. (Edi Shukriu)

KOCI Akil (1936-). Kompozitor, pedagog. Lindi në Prizren, ku kreu Shkollën e Mesme të Muzikës. Kreu Akademinë e Muzikës në Sarajevë, drejtimi teorik-pedagogjik. Ishte kryeredaktor muzikor në Radio-Prishtinë, më pas në Radiotelevizionin e Prishtinës. Kreu studimet pasuniversitare për muzikologji në Sarajevë. Ishte ligjërues në degën e muzikës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Regjistroi kompozimin në Shkup, por e ndërpreu. Ishte bursist i fondacionit gjerman për zhvillime akademike (DAAD) nga muzika instrumentale në Fakultetin "Hanns Eisler" në Berlin. Veprat e tij kanë tingëllimë moderne, me teknika të ndryshme dhe me motive të muzikës shqiptare. Ka kompozuar baletin e parë në Kosovë "Sokoli e Mirusha" dhe vepra të tjera korale, instrumentale, kamerale e orkestrale, të ekzekutuara në Dubrovnik, Beograd, Sarajevë, Tiranë, në festivalet Tribuna Muzikore Jugo-sllave në Opati, në Bienalen Muzikore në



AKIL KOCI

Zagreb dhe në festivale muzikore në Kosovë. Ishte bashkëthemelues i festivaleve “Skena muzikore e Prishtinës”, “Ditët e Muzikës Kosovare”, “Akordet e Kosovës”. Ishte sekretar, nënkryetar dhe kryetar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës si dhe i Lidhjes së Kompozitorëve të Jugosllavisë. Është aktiv me shkrime muzikore të botuara në revista për kompozitorë tanë dhe të huaj, anëtar i redaksisë së revistave “Zvuk” e “Nota”etj. Në garat muzikore në Prishtinë njëri nga çmimet mban emrin e tij. Është shpërblyer me mirënjohje në 70-vjetorin e lindjes në Kosovë dhe Kroaci. Në Londër, ku jeton e vepron, mban titullin “Ambasador i Kulturës Shqiptare”. (Besa Luzha)

KOCI Melazim (1956-). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Shkencave Politike në Zagreb. Në fund të vitit 1978 u punësua gazetar dhe redaktor në redaksinë e politikës së jashtme të Televizionit të Prishtinës (TVP). Në vitet 1986-89 ishte redaktor përgjegjës i programin informativ dhe dokumentar në TVP, ndërsa në vitet 1989-90 korrespondent i TVP-së në Sarajevë. Pas mbylljes së dhunshme të TVP-së (1990), përkatësisht në periudhën 1990-1992, ishte kolumnist i rregullt i gazetës së përditshme “Oslobogjenje” të Sarajevës, ndërsa në vitet 1995-1999 redaktor në gazetën “Bota sot” dhe nga shkurti 1999 redaktor dhe moderator në programin në gjuhën shqipe në Radion “Evropa e lirë” në Pragë. Në periudhën 2012-2013 punoi si producent ekzekutiv i programit informativ të Radiotelevizionit-21. (Artan Krasniqi)

KOÇINAJ Ymer (1933-2015). Mjek, internist, kardiolog, profesor universiteti. Lindi në Vermicë të Prizrenit, shkollën fillore e mbaroi në Zhur, ndërsa gjimnazin në Prizren. U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1961. Pesë vjet punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Prizren, pastaj kaloi në repartin internistik po në Prizren. Specializimin nga mjekësia interne e kreu në Universitetin e Beogradit. Me



YMER KOÇINAJ

hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u punësua në Klinikën Interne. Subspecializoi në

degën e kardiologjisë në Universitetin e Zagrebit (1973). Gjatë vitit 1974 qëndroi në Pragë të Çekosllovakisë në Institutin për Sëmundje Koronare. Mbaroi studimet pasuniversitare në vitin 1974, ndërsa temën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1976). U zgjodh asistent në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe më 1974 u emërua ligjërues, më pas profesor inordinar dhe më 1983 profesor ordinar. Ishte drejtor i Klinikës Interne për disa vjet. Një periudhë (1987) ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë. Në vitin 1990 u largua nga puna bashkë me kolegët e tij, ushtroi veprimtarinë private dhe vazhdoi punën në Fakultetin e Mjekësisë në kushtet e organizimit të mësimin në rrethana të jashtëzakonshme. Mori pjesë në shumë simpoziume dhe kongrese dhe është autor i një sërë punimesh profesionale dhe shkencore. Ishte bartës i shumë mirënjohjeve dhe dekoratave. (Ilir Begolli)

KODI I DUSHANIT. Përmbledhje ligjesh që dolën gjatë sundimit të Stefan Dushanit (1331-1355). Pjesa e parë e këtij kodi u shpall në kuvendin e Shkupit (1349), ndërsa pjesa e dytë më 1354, në kuvendin e Serit (Greqi). Kodi i Dushanit duhej t'i shërbente kodifikimit të legjislacionit, sidomos forcimit të pushtetit të tij dhe të pozitës së kishës rasiene-serbe në trevat e pushtuara. Në kod përfshihen edhe dispozitat e së drejtës martesore, civile dhe të kodit penal. Baza e dispozitave të Kodit të Dushanit ishte sajuar nga e drejta bizantine. Kodi përbëhet nga 201 nene dhe konsiderohet më i rëndësishmi në Rashë, përkatësisht në Serbinë mesjetare. Ai njihete tri kategori të popullsisë së perandorisë së tij: fisnikët (pronarë të mëdhenj të tokave), serbët (trashëgimtarë të tokës) dhe otrokët (robërit). Sipas këtij kodi, Stefan Dushani ishte perandor ortodoks dhe mbrojtës i fesë nga heretikët, që do të thotë se ai qeveriste edhe me punët kishtarë. Kodi u miratua për të siguruar pozitën e privilegjuar të fisnikërisë dhe të forconte pushtetin në tokat e pushtuara. Në pjesën e mbrojtjes së fesë nga herezia latine, parashiheshin dënime të rënda, përfshirë edhe dënimin me vdekje kundër heretikëve katolikë e bizantinë-ortodoksë, që ishin kryesisht shqiptarët. Ata duhej të ktheheshin me forcë në besimin e vërtetë, pra të konvertoheshin detyrimisht në fenë ortodokse rasiene-serbe. (Ramiz Abdyli)

KODRA Fadil (1965-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm të komunës së Skënderajt. Nga viti 1991 ka qenë në bashkorganizim me grupin e komandantit Adem Jashari. Mori pjesë në grupin e parë për stërvitje ushtarake në Shqipëri dhe më pas u kthye në Kosovë. Ishte pjesëmarrës në një sërë aksionesh kundër policisë serbe, si në Runik, Shipol, Mitrovicë etj. Në korrik të vitit 1997 gjykata serbe në Prishtinë e dënoi në mungesë me 20 vjet burg. Në tetor të vitit 1997 mori pjesë në aksionin kundër policisë serbe në Drenas, sërish në Runik, ndërsa më 26 nëntor 1997 mori pjesë në bllokimin e aksit rrugor Skënderaj-Drenas. Ishte pjesëmarrës edhe në luftimet e Likoshanit e të Çirezit (28 shkurt 1998), në Pantinë (Zona e Shalës), në betejën e Llapushnikut, në Prekaz të Poshtëm, luftimet në Rezallë, Tërnac, Prekaz i Epërme etj. Gjatë luftës ka qenë shef i zbulimit dhe i kundërzbulimit në kuadër të Shtabit të Zonës Operative të Drenicës. Pas lufte ishte i angazhuar në Trupat Mbrotjëse të Kosovës dhe më pas në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës. (Sabit Sylja)

KODRA Ilaz (1966-1999). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm, komuna e Skënderajt. Ishte njëri ndër pjesëtarët e gru-



ILAZ KODRA

peve dhe celulave të para të luftës çlirimtare në Kosovë. Nga viti 1991 bënte pjesë në grupin e Adem Jasharit. Ishte në grupin e parë që shkoi për stërvitje ushtarake në Shqipëri. Mori pjesë në luftime, pas sulmit të 30 dhjetorit 1991 nga forcat serbe ndaj familjes Jashari. Ishte pjesëmarrës në një sërë aksionesh kundër policisë serbe, në Runik të Skënderajt (19 dhjetor 1992), në Drenas (22 maj 1993) etj. Nga gjykata serbe e Prishtinës, në korrik të vitit 1997 u dënua në mungesë me 20 vjet burg. Një kohë emigroi në Gjermani. Më 6 maj të vitit 1997, bashkë me Fehmi e Xhevë Lladrovcin, Abedin Rexhën, Ramush e Luan Haradinajn, Sami e Rafet Ramën etj. bënte pjesë në grupin që u nisën të hynin nga Shqipëria në Kosovë, por afër Kushninit të Hasit ranë në pritën e forcave serbe. Në tetor të vitit 1997 në Drenas mori pjesë në ak-

sionin mbi stacionin e policisë. Më 26 nëntor 1997 ishte pjesëmarrës në betejën e UÇK-së në Klysyre. Në shtator të vitit 1998 u emërua komandant i Brigadës 114 "Fehmi Lladrovci" të Zonës Operative të Drenicës. Ra në luftimet e zhvilluara në fshatin Vërbofc më 30 prill 1999. Pas luftës iu ndanë dekorata e mirënjohje të shumta, përfshirë Urdhrin "Hero i Kosovës". (Sabit Sylja)

KODRA Masar (1932-2003). Historian, profesor universiteti. Lindi në Dibër. Shkollën fillore e kreu vendlindje, ndërsa të mesmen në Shkup. Studimet i filloi në Fakultetin Filozofik të Shkupit dhe i përfundoi në Fakultetin Filozofik të Lubjanës (1956). Punoi disa vjet si mësues dhe gazetar në gazetën "Flaka e vëllazërimit" (1960-1966). Në periudhën 1966-1975 punoi në Institutin e Historisë në Shkup. Ndërkohë mbrojti disertacionin e doktoratës në Zagreb (1972) dhe po atë vit u zgjodh mësimdhënës në degën e historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi deri në pensionim (1991). Ishte njëri nga nismëtarët e themelimit të Universitetit të Tetovës, ku kreu detyrën e dekanit të Fakultetit Filozofik dhe të mësimdhënësit të disa lëndëve të historisë. Ka botuar monografitë: "Shqiptarët e Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore 1939-1944" (1996), "Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane 1918-1945" (1997). Ishte ndër organizatorët e simpoziumit "Shqiptarët e Maqedonisë (Shkup, dhjetor 1991), materialet e të cilit u botuan po me atë titull (1994). Publikoi një varg artikujsh shkencorë në revistat shkencore në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. (Ramiz Abdyl)

KODRA Xhemë (1946-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm, komuna e Skënderajt. Më 1981 ishte pjesëmarrës i demonstratave studentore në Prishtinë. Fillimisht ishte anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e më vonë i Partisë Republikane. Mori pjesë në luftimet kundër forcave serbe më 30 dhjetor 1991 gjatë rrethimit të parë të familjes Jashari. Më 26 nëntor 1997, atë ditë që u zhvillua beteja në Klysyre mori pjesë në bllokimin e aksit rrugor Skënderaj-Drenas, afër fabrikës së vjetër të tjegullave. Ishte pjesëmarrës edhe në betejën e Likoshanit më 28 shkurt 1998. Më pastaj ishte epror në sektorin e zbulimit në Zonën

Operative të Drenicës dhe mori pjesë edhe në një sërë luftimesh në kuadër të kësaj zone. U plagos në fshatin Çubrel më 25 mars 1999. Pas luftës, pas demilitarizimit të UÇK-së kaloi në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ku gjithashtu ishte epror në sektorin e zbulimit. (Skënder Lutfiu)

KODRA Zenun (1963-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare (UÇK). Lindi në fshatin Prekaz i Poshtëm, komuna e Skënderajt. Ishte pjesë e grupeve të para të armatosura guerile në Kosovë. Nga viti 1991 bënte pjesë në grupin e komandantit Adem Jashari. Kur forcat serbe sulmuan familjen Jashari më 30 dhjetorë 1991 ishte në mbrojtje të kësaj familjeje. Më pas mori pjesë në aksionin tek Ura e Gjakut në Mitrovicë në qershor të vitit 1996. Në korrik të vitit 1997 gjykata serbe në Prishtinë e dënoi në mungesë me 20 vjet heqje lirie. Mori pjesë edhe në aksionin mbi stacionin e policisë në Drenas në tetor të vitit 1997. Ishte pjesëmarrës në betejën e parë frontale ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe në Klysyre më 26 nëntor 1997, pastaj në luftimet e Likoshanit dhe të Qirezit (28 shkurt 1998). Kishte pozitën shefit të operativës në komandën e Zonës Operative të Drenicës. Gjatë vitit 1998 mori pjesë aktivisht në luftimet e zhvilluara në Polac, Prekaz, Lubovec, Pantinë. U plagos në Prekaz, gjatë ofensivës së shtatorit 1998. Pas luftës ishte i angazhuar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në institucione të tjera të vendit. (Sabit Sylja)

KOFOS Evangelos (1934-). Historian grek, profesor. Lindi në Edesa të Greqisë. Studimet themelore i kreu në Selanik. Më 1955 kreu studime për gazetari në Athinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Uashington, ndërsa studimet e doktoratës në Londër (1993). Shërbeu për më shumë se tridhjetë vjet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Greqisë, si këshilltar special për çështjet e Ballkanit. Është autor i një numri të librave dhe artikujve shkencor mbi çështjet greke dhe ballkanike si: "Greqia në kohën e Krizës Lindore 1875-1878" (1975); "Nacionalizmi dhe komunizmi në Maqedoni" (1964) etj. Në vitet e fundit ai ka qenë i angazhuar me projekte që kanë të bëjnë me çështjet e Maqedonisë dhe të Kosovës. Në vitin 1998, në bashkëpunim me Thanos Veremis, botoi librin "Kosova, shmangia e një lufte ballkanike" dhe më pas librin "Bashkimi

i Kosovës dhe Shqipërisë" etj. Në vitin 1999, presidenti i Greqisë e dekoroi me medaljen presidenciale "Kryqi i Artë i Urdhrit të Feniksit", ndërsa më 2010 Akademia e Athinës i dha çmim për kontributet e tij shkencore. (Frashër Demaj)

KOHEN Ana (Anna) (1947-). Mjeke, stomatologe, aktiviste humanitare. Lindi në Vlorë nga prindër hebrenj, të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore, më 1943, nga Janina e Greqisë



ANA KOHEN

kishin ikur në Shqipëri dhe ishin vendosur në Trevëllazër të Vlorës. Në vitin 1966, si shtetas grekë u lejohet të largohen nga Shqipëria, kur A. Kohen ishte studente e stamatologjisë në Universitetin e Tiranës. Pasi përfundoi studimet në Athinë, migroi në SHBA, në Nju-Jork, ku kreu edhe shkollën dentare të Universitetit të Nju-Jorkut dhe hap klinikën private në Manhatan. Që nga vendosja në Amerikë mban kontakte të vazhdueshme me komunitetin shqiptar të Nju-Jorkut. Në vitin 1989 shkoi në Shqipëri dhe përmes shoqatave të hebrenjve për emigracion tërheq nga Shqipëria anëtarët e tjerë të familjes së gjerë që kishin mbetur në Shqipëri. Në vitin 1998 u zgjodh kryetare e Shoqatës "Motrat Qiriazit" në Nju-Jork. Gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, bashkë me aktivistë të tjerë, zhvilloi një aktivitet të dendur në përkrahje të Kosovës dhe për organizimin e ndihmave humanitare. Përfshirja e saj në mbështetje të Kosovës pati ndikim të madh te komuniteti hebre i Nju-Jorkut. Vazhdon të jetë pjesëmarrëse në të gjitha aktivitetet e komunitetit shqiptar në Nju-Jork. (Isuf Dedushaj)

KOHORTAT AURELIANE DARDANE. Njësitë ushtarake të krijuara prej latronëve dardanë nga perandori romak, Mark Aureli (169). Kohortat u krijuan për shkak të rezistencës së latronëve dardanë kundër pushtimit romak dhe për mbrojtjen e minierave në Timakus Minus (Ravnë) nga sulmet e Markomanëve. Kohorta Dardane I kishte 700 ushtarë dhe Kohorta Dardane II 1,000 ushtarë, prej të cilëve 1/3 ishin kalorës. Në përshkrimet e Jul Cezarit (49-44 p.e.r.) kushtuar luftërave galike thuhet se Timakus Minus ishte qendra e latronëve

dardanë. Kohortën e parë Aureliani e formoi në Timakus Maius, në veri të Nishit dhe kjo fitoi titullin honorifik “Cornacum” për shkak të sukseseve të arritura në luftërat në kufijtë veriorë të Dakisë dhe të Panonisë (212-214). Kohorta Dardane II u formua për t’i mbrojtur minierat në Timakus Minus. Shënimet epigrafike të kësaj kohorte janë gjetur në Praesidium Pompei (Aleksinac) dhe në një stellë tjetër të gjetur në Timakus Minus. Në këtë të fundit përshkruhet dhe puna e Ulpius Aquilimus si oficer që vinte nga Viminaciumi (Kostolac) dhe që kujdesej për shpërndarjen e detyrimeve të veteranëve të Kohortës Dardane II, të stacionuar në kuadër të legjionit VII të Klaudit. Prezenca e Kohortës II në Timakus Minus vazhdoi deri në fund të shek. IV, kur u zëvendësua me pseudokomitatensët. (Arianit Buqinca)

KOJÇINI-UKAJ Sulltane (1947-). Historiane. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe shkollën normale i përfundoi në vendlindje. Punoi disa vjet në arsim në Pejë, Istog, Banjë të Pejës dhe në Krushë të Madhe. Më pas kreu studimet për histori në Universitetin e Prishtinës (1975). Kreu edhe studimet pasuniversitare dhe më 1984 mbrojti temën e doktoratës. Nga viti 1975 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë. Ishte pjesëmarrëse e aktiviteteve të shoqatave të grave që nga fillimi i viteve ’90 dhe të Forumi i Gruas të LDK-së (1995-2000). Ishte anëtare e bordit të Qendrës për Trajnime dhe Studime Gjinore dhe mori pjesë në konferenca dhe simpoziume të ndryshme shkencore në organizimin e kësaj qendre. Në 2005-2009 punoi mësimdhënëse në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë dhe Gjiilan, si dhe bashkëpunëtoresh jashtme e Universitetit të Prishtinës. Është autore e monografive: “Kudri arsimor në Kosovë në shënjestër të sigurimit shtetëror 1945-1952” (1997) dhe “Zhvillimi i arsimit në Kosovë 1945-1952” (2006). Ka botuar një varg artikujsh shkencorë dhe publicistikë. (Izber Hoti).

KOJIQ (Kojić) Agan (1946-). Vreshtar, profesor universiteti. Lindi në fshatin Përnjavor të Plavës, në Mal të Zi. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme bujqësore në Pejë (1968), kurse studimet i kreu në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës, drejtimi pemëtari-vreshtari (1973). Punoi në kombinatin bujqësor industrial “Progres-Export” në Prizren, në kombinatin

“Rahovec” dhe më pas në Institutin Bioteknik në Pejë. Studimet pasuniversitare i përfundoi në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Beogradit (1981), ndërsa tezën e disertacionit e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës (1989). U zgjodh ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë dhe më pas në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës. Publikoi një numër punimesh shkencore dhe profesionale, si dhe realizoi disa projekte për ngritjen e vreshtave. Është autor i disa tekste universitare nga vreshtaria. (Agim Zajmi)

KOKA E AKTORIT (ULPIANË). Portret mashkull i skulpturuar, i njohur edhe si “Maska tragjike”. Paraqet një shprehje të fuqishme mashkullore me veçori të qarta të maskave



KOKA E AKTORIT

teatrale romake. Është gdhendur në mermer të hirtë (27.5 cm), me detaje groteske të fytyrës, sy të futur në gropëza të mëdha të syve, ngjashëm me maskat e njohura teatrale romake. Portreti është një nga gjetjet më të spikatura të Ulpianës, mbase i importuar nga një qendër e njohur e artit romak. U takon modeleve të hershme, por koka nga Ulpiana mund të datohet në shek. II. U zbulua në Nekropolin Verior dhe dëshmon prezencën e teatrit dhe të veprimtarive teatrale në Ulpianë. (Pleurat Kabashi)

KOKA Mustafë (1931-1951). Mësues dhe veprimtar i lëvizjes antikomuniste. Lindi në fshatin Kokaj të Gjiilanit. Në nëntor të vitit 1944, në moshën 17-vjeçare u bashkua me njësitet partizane të brigadave shqiptare dhe u vendos në Tiranë. Në fund të vitit 1947 kthehet në Kosovë dhe fillon punën si mësues. Punoi në Uglar, Lubishtë dhe Remnik. Meqenëse OZNA e përcillte veprimtarinë e tij, në qershor të vitit 1951 doli në mal dhe iu bashkua grupit të Hasan Remnikut. Një kohë qëndroi i fshehur në fshatin Lubishtë të Vitisë, pastaj në fshatrat Rahovicë dhe Strezoc të Preshevës. Në vjeshtë të vitit 1951, së bashku me Hasan Remnikun dhe shokët tjerë, vendosën të iknin për Shqipëri. Më 10 tetor 1951, duke kaluar lumin Lumbardh të Prizrenit ranë në pritë të forcave serbe, me ç’rast vritet tërë grupi i Hasan Alisë,

në mesin e të cilëve gjendej edhe M. Koka, bashkë me gruan e tij. Pas vrasjes trupat e tyre ekspozohen në Viti dhe në Gjiilan. Varri nuk i dihet. (Naim Musliu)

KOKAJ Jahja (1948-). Fizikan, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore



JAHJA KOKAJ

(FSHMN) në Universitetin e Prishtinës (UP). Studimet e doktoratës i vazhdoi në Zagreb dhe në Moskë. Tezën e disertacionit e mbrojti në FSHMN të UP-së. Studimet pas doktoratës i vijoi në SHBA, në Universitetin Carnegie Mellon, në

Pitsburg. Gjatë kësaj kohe ishte i përfshirë në projektin e hulumtimeve optike të modelit të tuneleve të rrymimeve të furishme, që e financonte NASA. Themeloi laboratorin e holografisë në FSHMN të Universitetit të Prishtinës, ku janë realizuar hulumtime shkencore dhe disertacione të doktoratës. Pas përjashtimit kolektiv nga Universiteti, vazhdoi punën në Pitsburg, si hulumtues dhe profesor i optikës laserike. Në të njëjtën kohë ka punuar në projektin "Litton". Punon dhe jeton në Kuvajt. Ka botuar punime dhe ka marrë pjesë në tubime shkencore me karakter ndërkombëtar. Është autor i librit të parë për laserët ("Laserët") i botuar në Prishtinë dhe në Tiranë. (Zahadin Shemsedini)

KOKAJ Syme (1949-). Mësuese aktiviste. Lindi në Draginë, Ana e Malit, komuna e Ulqinit, në Mal të Zi. Pas tetëvjeçares në Katërkollë, kreu Shkollën Normale në Gjakovë. Vijoi studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit. Në vitin 1969 bëhet mësuese në Katërkollë. 35 vjet ishte mësime dhe e gjuhës dhe e letërsisë shqipe në shkollën tetëvjeçare të Katërkollës. Dy herë ishte anëtare e komisionit për plan-programet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Mal të Zi, pastaj themeluese dhe kryetare e Fondacionit "Studenti". U mor edhe me aktivitet politik. Në vitin 1981 akuzohet për nacionalizëm. Është autore e veprës "Arsimi shqip në Anë të Malit 1945-1985" (2012) dhe e përmbledhjes poetike "Det i trazuar" (2014). (Ali Lllunji)

KOKOLLI Sahit (1955-). Kameraman. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, studioi për elektroteknikë dhe gjuhë angleze në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1975 punoi asistent kamere dhe kameraman në Televizionin e Prishtinës. Në vitin 1993 bashkëthemelon videoproduksionin "Vizioni", i specializuar për prodhimin e programeve muzikore, argëtuese dhe dokumentare. Nga viti 2000 angazhohet kameraman për televizionin publik të Gjermanisë ARD, për ngjarjet në Kosovë dhe Shqipëri. Nga viti 1974 ishte i angazhuar në realizimin e shumë projekteve filmike dhe dokumentare, si asistent kamere ("Era dhe lisi", "Tre vetë kapërcejnë malin" etj.) dhe drejtor fotografie ("Era e mollës", "Gjurmët", "Vjeshta e trëndafilave" etj.). (Shaqir Foniqi)

KOL Kristine fon (Christine von Kohl) (1923-2009). Gazetare, aktiviste për të drejtat e njeriut. Lindi në Berlin. Fëmijërinë e kaloi në Gjermani. Studimet për filozofi dhe histori



KRISTINE FON KOL

krahasimtare të rajoneve i ndoqi në Universitetin e Kopenhagës. Në vitin 1960 u vendos në Vjenë, si korrespondente e mjeteve skandinave të informimit. U shqua për mbështetjen që i jepte Simon Wiesenthalit dhe qendrës së tij për dokumentimin e viktimave hebraike të nazizmit. Nga viti 1968 deri më 1985 qëndroi në Beograd, si korrespondente e medieve gjermane, austriake dhe skandinave. Ishte njohëse e mirë e historisë dhe e zhvillimeve politike në rajon. Mbrojti të drejtat e shqiptarëve dhe boshnjakëve, dy popujve më të pambrojtur në ish-Jugosllavi. Analizat e saj për çështjet e Ballkanit vlerësoheshin nga organizatat ndërkombëtare, institucionet shtetërore dhe qarqet universitare. Angazhimi i saj për Kosovën u intensifikua në periudhën 1990-1994, si këshilltare për Ballkanin në Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Që nga ajo kohë dha kontribut të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Nga viti 1999 ishte botuese dhe redaktore përgjegjëse e revistës "Ballkani ndryshe /Dialogu i Europës Juglindore". Është autore dhe bashkautore e shumë librave, si: "Jugosllavia" (1990), "Kosova: nyja Gordiane në Ballkan" (1992),

“Shqipëria” (1998), “Ballkani: stabilitet apo kaos në Evropë” (2000), “Një daneze në Ballkan” (2008), disa nga të cilët janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Vdiq në Vjenë. (Arbër Salihu)

KOLAJ Anton (1953-). Politikan, sociolog. Lindi në Zllakuqan të Klinës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e mbaroi në Klinë. Diplomoi për sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve 1977-1989 punoi mësimdhënës në gjimnazin “Luigj Gurakuqi” në Klinë dhe Kijevë. Në vitin 1989 u arrestua në të ashtuquajturin proces të izolimit të 250 intelektualëve shqiptarë të Kosovës. Nga dhjetori 1989 e deri në maj të vitit 1990 punoi si sociolog i punës në ndërmarrjen “Mirusha” të Klinës, nga ku u largua për shkak të bindjeve politike. Më 1990 u bë anëtar i kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe me vonë nënkryetar i saj në kuvendin e parë zgjedhor (1991). Ishte deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e 24 majit të vitit 1992 të organizuara nga LDK-ja dhe ministër i Ministrisë së Mbrojtjes i Qeverisë së Kosovës në mërgim. Në vitin 1995 emigroi në Gjermani, ku punon si pedagog social. (Nerxhivane G. Dauti)

KOLASHINI I IBRIT. Krahinë në veriperëndim të Kosovës, në perëndim të Mitrovicës. Ndryshe njihet si Kolashini i Vjetër. Shtrihet nga kufiri me Serbinë në perëndim, deri te gryka e Ibrit në Zubçë në lindje (afër Mitrovicës). Përfshin luginën e epërme të Ibrit me gjatësi 32 km, si dhe Rogoznën dhe Malin e Thatë, në gjerësi 16 km. Shtrihet në sipërfaqe rreth 315 km². Është krahinë tipike malore, në të cilën dallohen tri tërësitë gjeografike: Lugina e Ibrit, e prerë mes maleve të Moknës dhe Rogoznës ndan këtë krahinë në pjesën veriore (Rogoznën) dhe jugore (Moknën dhe Malin e Thatë). Lugina karakterizohet me ngushtica (gryka) dhe rrafshje aluviale. Në njërën nga këto gryka është ngritur diga më e madhe në Kosovë, që ka mundësuar krijimin e akumulacionit më të madh të ujit në Kosovë, Liqenin e Ujmanit. Në anën jugore të Ibrit shtrihet masivi i Mokrës dhe Mali i Thatë. Janë male me lartësi deri në 1,751 m (Radopole) me rënie graduale, ndërsa malet e Rogoznës janë më të ulëta, deri 1,479 m, me shpate më të pjerrëta që lëshohen në drejtim të Ibrit. Ka klimë malore kontinentale,

me reshje, të cilat në luginë arrijnë deri afro 750 mm, ndërsa në zonën malore të Mokrës deri 1,050 mm. Rrjetin hidrografik e përbën lumi Ibër me 27 degë. Pozita dhe kushtet e përshtatshme klimatike kanë kushtëzuar që kjo krahinë të banohet që nga koha antike. Kjo trevë është shkëputur nga Mitrovica dhe është organizuar si komunë e veçantë (Zubin Potoku). Janë 61 vendbanime të populluara me shumicë serbe. Për shkak të kushteve ekonomike dhe rrethanave politike, shumë fshatra kanë mbetur pa banorë. (Bektesh Vidishiqi)

KOLÇI Ibrahim (1888-1960). Mësues atdhetar. Lindi në Gjakovë, ku mori edhe arsimin fillor dhe filloi arsimin e mesëm. Me ndihmën e Bajram Currit, vijoi shkollën normale turke në Shkup dhe studime për drejtësi në Stamboll. U shqua për punën e tij si mësues. Ishte bashkëpunëtor me mësuesit dhe atdhetarët e shquar të kohës: Naim Ferizi, Sali Morina, Ferid Nimani, Ibrahim Fehmiu, Ahmet Gashi, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani etj. Punën e mësuesit e filloi në vitin 1911. Ishte mësues, kryemësues ose drejtor shkolle në më shumë se 20 shkolla, si në Kala të Dodës, Krumë, Pejë, Gjakovë, Tiranë, Himarë, Kolgecaj, Golaj, Kukës, Bicaj, Tropojë, Shkodër etj., ku organizoi edhe kurse kundër analfabetizmit, aktivitete kulturore, politike e shoqërore. U shqua sidomos si novator në procesin mësimor. Ishte i përndjekur nga organet e sigurimit jugosllav, ndaj pati një jetë të vështirë. Për kontributin e tij I. Kolçi mori mirënjohje nga Misioni Amerikan i Kryqit të Kuq në Shqipëri, nga qeveria e Fan Nolit dhe nga presidenti i Republikës së Shqipërisë (1994). (Sabit Jaha)

KOLEKSIONI I VIKTOR GASHIT. Është një koleksion i pasur me ekzemplarë të shumtë dhe të larmishëm. Pjesën më të madhe të këtij koleksioni e përbejnë stolitë nga argjendi, si: vëthë, unaza, qostekë, paftë, qafore, gjerdanë, stoli koke etj. Këto stoli janë të punuara me teknika të ndryshme dhe dallojnë ndërmjet tyre si nga funksioni e dimensionet, ashtu edhe nga materiali me të cilin janë punuar. Përveç stolive, koleksionin e pasurojnë edhe disa ekzemplarë të armëve të vjetra, të cilat i përkasin kryesisht shek. XVIII-XX. Janë të dekoruara me mjeshtri me pafta të holla argjendi në të gjithë sipërfaqen. Të tilla janë pushkët e gjata, jataganët me këllëf, thikat, brisqet, koburet

e brezit etj. Ekzemplarë të tjerë, që zënë vend me rëndësi në këtë koleksion janë edhe veshjet popullore, si: jelekë, mitanë, përparëse, çorapë etj. Përveç sasisë dhe larushisë, ajo që bie në sy te këto objekte janë zbukurimet e larmishme me karakteristika të veçanta krahinore, si të Rrafshit të Dukagjinit, të Hasit, Drenicës etj. Koleksioni i Viktor Gashit ka edhe një numër jo të vogël të enëve prej bakri. Këto enë janë të larmishme si për nga funksioni, ashtu edhe për nga dimensionet dhe ana tipologjike. Janë të zbukuruar me motive të ndryshme, të ekzekutuara me incizim. Përveç këtyre objekteve, koleksionin e Viktor Gashit e pasurojnë edhe objekte të tjera, si: kryqe me dimensione të ndryshme të zbukuruar në tërë sipërfaqen e tyre, pastaj ikona, kandila, qirakë, shandanë, pipa të ndryshëm të punuar prej argjendi dhe fildishi etj. (Bashkim Lajçi)

KOLGECI Remzi (1947-2011). Funkionar politik i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në fshatin Vraniq të Suharekës. Shkollën fillore e kreu në Suharekë, të mesmen në Prizren, ndërsa në Universitetin e Beogradit mbaroi studimet për shkencë politike. Një kohë të shkurtër punoi në arsim në komunën e Suharekës, ndërsa më pas ligjëroi në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës. Nga viti 1968 deri në vitin 1978 ishte kryetar i Kuvendit Komunal të Suharekës. Si kryetar kontribuoi në zhvillimin e komunës dhe shkollimin e femrës shqiptare. Në periudhën 1978-1985 ishte zëvendëssekretar dhe sekretar në Sekretariatit Krahinor të Mbrotjtjes, ndërsa në vitet 1985-1987 ishte drejtor gjeneral i Fabrikës së gomës “Ballkan” në Suharekë, kohë kur kjo fabrikë shënoi suksese të rëndësishme në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Në periudhën 1987-1988 ishte anëtar i Kryesisë së KSA të Kosovës e më pas (1988-1989) ishte edhe kryetar i kësaj Kryesie dhe ushtrues i detyrës së kryetarit të Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunitëve të Kosovës. Në këtë post ishte deri në momentet e suprimimit të autonomisë së Kosovës më 1990. Po në këtë vit dha dorëheqje nga të gjitha postet politike dhe shtetërore. Pas luftës në Kosovë u mor me biznes dhe u angazhua si këshilltar dhe drejtor i disa kompanive. (Arbër Salihu).

KOLGECI Salih (?-1989). Mësues, gjuhëtar, përpilues i teksteve shkollore, përkthyes. Lindi në Kolgecaj të Tropojës. Ka kryer Shkollën

Normale të Elbasanit, punoi si mësues në Shishtavec (1932-1933). Më 1941 është dërguar në Kosovë. Ka punuar në shkollën fillore “Bogdani” në Gjilan (1941-1942), drejtues i kurseve të gjuhës shqipe për të rritur në Ferizaj dhe zv.drejtor i Drejtorisë Didaktike të Gjakovës (1942-1943). Ka dhënë mësim në Gjimnaz dhe në Shkollën Normale në Prishtinës. Bashkautor (M. Gjevori, S. Kolgeci, I. Riza, Sh. Rexhepi) i tekstit të parë shkollor të botuar në Kosovë “Abetare për të rriturit” (Prizren, 1946). Bashkautor i gramatikave dhe librave të leximit për shkollat tetëvjeçare dhe klasat e ulëta të gjimnazit, si dhe i “Fjalorthit për matematikë, fizikë, kimi, industri, teknikë e komunikim” (1953-1955). Është marrë me mbledhjen e folklorit dhe me çështje të drejtshkrimit e të gramatikës së gjuhës shqipe. Ka qenë bashkëpunëtor i Institut Albanologjik, i revistës “Përparimi” dhe i Radio-Prishtinës. Më 1958 pushteti jugosllav e ka deportuar në Shqipëri. Më 1994 S. Kolgeci është dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë për kontributin për hapjen e shkollave dhe punën arsimore në Kosovë në periudhën 1941-1944. Ka vdekur në Elbasan. (Nebi Caka)

KOLGJINI Tahir (1903-1988). Imam, studiues, poet dhe historian. Lindi në Lamshejt të Lumës. Me fillimin e luftërave ballkanike emigroi me familjen në Stamboll. Aty mbaroi mësimet në Medresenë e Lartë “Dar-ul-Hilafet-ul-Aliyye”. Ushtrroi disa funksione: mësues, sekretar gjykate, kryetar bashkie, zëvendësprefekt, prefekt dhe drejtor i përgjithshëm i policisë. Shkroi artikuj, punime e studime në fusha të ndryshme, me përmbajtje letrare, politike, kulturore dhe shkencore. Kontributet e tij janë botuar me pseudonimet Lok Limthi, Dylej, Dashamiri, por edhe me emrin e tij. Botoi veprat: “Të vërtetat shqiptaro-greke” (Arnavutluk ve Yunistan Gerçekleri, Stamboll 1968; shqip, Tiranë 1997); “Shpalime rreth Lahutës së Malcís” (Stamboll, 1969), “Luma dhe luftat e saj” (Stamboll, 1970); “Esad Pashë Toptani dhe akuzat q’i bahen” (Stamboll, 1977); “Po vajtojmë Gjon Gjinyin” (Stamboll, 1979). (Jahja Hundozi)

KOLIQI Ernest (1903-1975). Shkrimtar, përkthyes, studiues i letërsisë, botues, veprimtar i arsimit, profesor universiteti. Lindi në Shkodër. Pas shkollës fillore dhe Kolegjes Saveriane në



ERNEST KOLIQUI

Shkodër, vazhdoi shkollimin në Arice të Lombardisë (Itali). Në vitin 1922 u kthye në atdhe dhe u integrua në jetën kulturore dhe politike në vend. Dy vjet më vonë, për shkaqe politike, emigroi në Jugosllavi, ku qëndroi 5 vjet. Në vitet 1929-1932 ishte mësimdhënës në Vlorë dhe në Shkodër, për të vazhduar studimet e larta për letërsi në Universitetin e Padovës (1933-1937). Në periudhën prill 1939-dhjetor 1941, E. Koliqi ishte ministër i Arsimit në Qeverinë e Mbretërisë Shqiptare (nën pushtimin fashist italian). Kontribuoi shumë për ngritjen e sistemit të arsimit kombëtar në tërë territorin e “Shqipnis Ethnike”, me çrast u themeluan shumë shkolla filllore dhe të mesme në “tokat e lirume”. Në cilësinë e ministrit të Arsimit, në vitin 1941 dërgoi në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare disa qindra mësues për të hapur shkolla shqipe. Me nismën dhe angazhimin e tij u bë punë me vlerë për plotësimin literaturës shkollore, sidomos për shkolla të mesme, me veprat siç janë: “Shkrimtarët shqiptarë I-II” (1941), “Rreze drite”, “Te praku i jetës”, “Bota shqiptare” etj. Një numër të rinjsh shqiptarë edhe nga Kosova i dërgoi për studime në universitetet e Italisë. E. Koliqi ishte ministri i parë i sistemit të arsimit unik kombëtar. Ai ishte nismëtar i Kongresit të Studimeve Shqiptare (1940), themelues dhe drejtues i Institutit të Studimeve Shqiptare, nismëtar i botimit të serisë “Visaret e Kombit” etj. Pas largimit nga Shqipëria në vitin 1943 u mor me drejtimin e katedrës së gjuhës shqipe (prej vitit 1957 Instituti i Studimeve Shqiptare) në Universitetin “La Sapienza” në Romë, ku qëndroi deri në fund të jetës. E. Koliqi u shqua, sidomos në krijimtarinë letrare. Me veprat e tij “Kushtrim i Skanderbeut” (1924), “Hija e Maleve” (1929), “Tregtar flamujsh” (1935), “Gjurmat e stinëve” (1933), “Pasqyrat e Narçizit” (1934), “Simfonia e shqypeve” (1936) etj., shënoi një hap cilësor në prozën shqipe. Cilësohet si njëri nga themeluesit e novelës moderne shqipe. Pas Luftës së Dytë Botërore shkroi veprat “Kangjelet e Rilindjes” (1959), “Shija e bukës së mrumë” (1960) dhe “Rranjët lëvizin” (1970). Një sërë shkrimesh të tij letrare i botoi në veprën “Studime për letërsinë shqiptare” (1972).

Kontribut të veçantë dha edhe në fushën e përkthimit letrar, sidomos me veprën në dy vëllime “Poetët e mëdhej t’Italis” (1932, 1935). Nga gjuha shqipe në atë italiane përktheu disa këngë nga “Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës, poemën “Dasma shqiptare” të A. Asllanit dhe një antologji të lirikës shqiptare. Kontribut të veçantë dha në studimin e letërsisë popullore shqipe dhe njohjen e opinionit italian me këtë krijimtari, duke përfshirë këtu tezën e doktoratës “Epika popullore shqiptare” (Epica popolare albanese), si dhe veprat “Poesia popullore shqiptare” (Poesia popolare albanese, 1957), “Rapsodë dhe rapsodi të Alpeve Shqiptare” (Rapsodi e rapsodie delle Alpi Albanesi, 1960). Vend të veçantë zë kontributi i tij në shtypin kulturor shqiptar, si bashkëdrejtues i revistës “Illyria” (1934-1936), si themelues i revistës “Shkëndija” (1940-1943), sidomos me revistën “Shëjzat” (1957-1974). (Ali Lllunji)

KOLIQUI Hajrullah (1946-). Pedagog, profesor universiteti. Lindi në Kështenjë (Krajë), komuna e Tivarit, në Mal të Zi. Shkollën filllore e kreu në vendlindje, përkatësisht në Ostros. Pas



HAJRULLAH KOLIQUI

Normales, studioi shkencat pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe doktoroi (1987). Një vit shkollor (1966/67) ishte mësues në vendlindje, ndërsa nga viti 1973 tërë karrierën e tij e zhvilloi në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, fillimisht në cilësinë e asistentit, pastaj të ligjëruesit, docentit, profesorit inordinar dhe atij ordinar. Ishte edhe bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Tetovës që nga themelimi i tij. Kreu detyra dhe funksione të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë dhe në asociacionet arsimore e pedagogjike, ndër të cilat edhe ministër i Arsimit dhe i Shkencës në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, kryetar i këshillit botues të Universitetit të Prishtinës, nënkryetar i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë (LASH), si dhe anëtar këshillash profesionale apo redaksish të disa revistave shkencore e kulturore. Bëri punë intensive për mbijetesën dhe pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë, sidomos të Universitetit të Prishtinës, në vitet 1991-1999. Ishte

ndër organizatorët e protestave të studentëve të vitit 1997. Fushat themelore të interesimit shkencor-profesional të H. Koliqit janë: historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar dhe botëror, andragogjia, pedagogjia krahasuese, filozofia e edukimit etj., për të cilat shkroi artikuj të shumtë shkencorë-profesionalë. Ishte edhe pjesëmarrës në shumë tryeza e konferenca shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Rezultat i punës së tij shkencore-profesionale janë edhe një varg veprash monografike, tekstesh universitare etj.: “Aleksandër Xhuvani - puna edukativo-arsimore dhe pikëpamjet pedagogjike” (1987), “Andragogjia” (1987), “Kraja ndër mote” (1993), “Mbijetesa e Universitetit të Prishtinës 1991-1994” (1995, përkthyer anglisht dhe gjermanisht), pastaj tekstet universitare dhe monografite: “Historia e pedagogjisë botërore” (1997), “Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar” (2002), “Sistemi i arsimit në Kosovë” (2004), “Thesar filoedukimi” (2005), “Jashar Rexhepagiqi, figurë e shquar e arsimit dhe e shkencës” (2009), “Gruaja ndër shekuj /Arsimimi dhe emancipimi i saj” (2009), “40 vjet të tempullit tonë të diturisë” (2010) etj. (Islam Krasniqi)

KOLIQUI Kushtrim (1984-). Regjisor. Lindi në Prishtinë. Studimet për regji teatri i mbaroi në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2010) në klasën e Fadil Hysajt. Realizoi shfaqje teatrore në Teatrin Kombëtar të Kosovës si dhe në teatro të tjera lokale e private, nga të cilat shquhen: “Hanibali i nëntokës”, “Çifti i hapur”, “Më afër”, dhe “Mbas Zonjushës Julie”, për të cilën nga Ministria e Kulturës e Kosovës mori çmimin vjetor për regjinë dhe shfaqjen më të mirë për vitin 2013. Është i angazhuar si regjisor dhe producent i prodhimeve mediale e filmike nga të cilët veçohet cikli i filmave dokumentarë narrativë “Njerëzit dhe kujtimet flasin”, për viktimat civile të luftës së fundit në Kosovë. (Fadil Hysaj)

KOLONITË ARTISTIKE. Veprimtari artistike e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës (SHAFK), e ngjashme me veprimtari të këtilla të shoqatave të artistëve figurativë të republikave dhe krahinave të ish-Jugosllavisë. Këto koloni artistike siguronin qëndrim njëjavor ose dyjavor të artistëve në ambiente piktoreske, me shpenzimet e shtetit. Artistët, individualisht ose në grupe, gjatë qëndrimit në koloni realizo-

nin punime artistike dhe organizonin ekspozita të rastit, në ambientet e dedikuara për këtë qëllim ose në ambiente hoteliere. Edhe SHAFK-u mbante takime të këtilla krijuese dhe pushimi në kolonitë artistike në Deçan, Brezovicë, Grozhanjan dhe Batllavë. Kolonia e Deçanit ishte ndër takimet më të frytshme të artistëve figurativë të Kosovës. Gjatë stinës së verës merrnin pjesë edhe Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës, me vonë edhe Shoqata e Artistëve Aplikativë. Çdo asociacion zhvillonte veprimtarinë e vet në mënyrë të pavarur. Përveç artistëve vendorë, në këto koloni merrnin pjesë mysafirë nga vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, por edhe nga jashtë. Pas demonstratave studentore të vitit 1981, kolonitë artistike e humbën ritmin e tyre. Kolonia e Deçanit kaloi për pak vjet në Brezovicë, e më vonë e pushoi veprimtarinë. Pas lufte (1999) u formuan edhe disa koloni artistike në baza vullnetare dhe grupore, që vepronë edhe sot në Kosovë dhe në Shqipëri. (Rexhep Goçi)

KOLONIZIMI I KOSOVËS (1918-1941). Ishte një ndër mjetet kryesore të diskriminimit, të krijimit të pasigurisë dhe të nxitjes së shpërnguljes masive ndër shqiptarët, për të realizuar spastrimin etnik të viseve të tyre. Më 1918 qarqet drejtuese të Serbisë rifilluan edhe më intensivisht shpronësimin agrar të shqiptarëve dhe kolonizimin sllav të filluar që më 1913. Me këtë proces u goditën të gjitha kategoritë e popullsisë shqiptare të lidhura me tokën dhe u favorizua pakica sllave ekzistuese dhe sidomos kolonët sllavë, të sjellë posaçërisht në viset shqiptare, për të ndryshuar strukturën etnike të popullsisë së këtyre zonave. Zbatimi i planit të kolonizimit të viseve shqiptare realizohej me vendosjen e kolonëve, në radhë të parë në pikat më strategjike, sidomos në brezin kufitar me Shqipërinë. Ndërkohë, përfitues nga reforma agrare kolonizuese ishin jo vetëm rreth 16 mijë familje bujqish serbë, por edhe shumë individë e zyrtarë, kryesisht të përkatësive etnike sllave.

Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore në tokat shqiptare u vendosën me dhjetëra mijëra kolonë. Numri i saktë i kolonëve të vendosur në Kosovë dhe hapësirat shqiptare nuk u tregua asnjëherë, sepse ata nuk u regjistruan në statistikat zyrtare. Por sipas burimeve, gjatë periudhës 1918-1941 në viset shqiptare u ngritën rreth 1,000 koloni sllave. Si rrjedhojë e zbatimit të politikës kolonizuese

u ashpërsuan edhe marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe minoritetit serbo-malazias. Në këto rrethana, pushteti serb organizoi banda të armatosura, siç ishin ato të Kostë Peçancit, të Miliq Kërstiqit etj., të cilat ushtruan dhunë e terror mbi shqiptarët.

Deri në fillim të vitit 1941, nga reforma kolonizuese u prek rreth gjysma e tokave bujqësore dhe u godit gati gjysma e popullsisë shqiptare të fshatit. Shpronësimi në masë i fshatarësisë shqiptare solli varfërimin e saj. Si rrjedhojë e shpronësimit dhe kolonizimit, pësoi ndryshime të dukshme edhe struktura etnike e popullsisë. Më 1912 shqiptarët në këto troje përbënin mbi 90% të popullsisë, kurse në vitin 1941 përqindja e tyre ra në rreth 70 përqind. Si rezultat i kësaj politike, deri në vitin 1941 në viset shqiptare ishin vendosur rreth 16 mijë familje kolonësh agrarë, me mbi 80 mijë anëtarë, nga të cilët gati 14 mijë familje në Kosovë. (Lush Culaj)

KOLLA E BARDHË. Është sëmundje ngjitëse akute kontagioze, që karakterizohet me sulme tipike të kollës te fëmijët, duke marrë herë pas here karakter epidemik, lokal apo të zgjeruar. Shkaktar i sëmundjes janë bakteret bordetella pertussis, kokobacil gramnegativ. Inkubacioni silltet prej 7-21 ditë, mesatarisht 10 ditë, që pasohet me simptome nazofaringeale, teshtimë dhe sulme të kollës që zgjasin prej 4 deri në 6 javë. Është sëmundje kozmopolite me karakter endemo epidemik. Të porsalindurit nuk trashëgojnë imunitet pasiv nga nëna dhe mund të sëmuren nga kolla e bardhë, që paraqet rrezik të lartë për shëndetin e tyre. Shkalla e vdekshmërisë është shumë e lartë nëse foshnjat sëmuren në gjashtë muajt e parë të jetës, pasi fëmija nuk trashëgon antitrupa nga nëna. Mbrojtja më e mirë është përmes vaksinimit, i cili ofron imunitet deri në 75%. Numri i rasteve të sëmundjes varet nga shkalla e përfshirjes në vaksinim. Gjatë viteve '70 numri i fëmijëve të sëmurë ishte i lartë dhe u zvogëlua me shtimin e numrit të fëmijëve të vaksinuar. Gjatë periudhës 1973-2001 u shënuan 29,021 raste me 298 vdekje, kurse në periudhën 2010-2013 u paraqitën 116 raste të sëmundjes, pa asnjë të vdekur. (Isme Humolli)

KOLLARI Jaho (1961-). Shkrimtar. Lindi në Ulqin. Kreu shkollimin fillor dhe të mesëm në vendlindje. Krijimet e para, poezi dhe tregime,

i botoi gjatë viteve '80, kryesisht në gazeta e revista në Kosovë dhe Mal të Zi. Botoi librat me poezi: "Shtëpia në mes ullinjve" (1988), "Poeti i mijëvjeçarit të tretë" (2014), "Prokrastinacioni" (2015), pastaj përmbledhjet me tregime "Terapia" (1997), "Plusquaperfekti" (2013) dhe Romanin "Lidhja me saturë" (1999). Një kohë jetoi në Suedi, pastaj në Gjermani. Kohë pas kohe shkruan recensione për libra të autorëve shqiptarë në Mal të Zi. (Haxhi Shabani)

KOMANDA E DOKTRINËS DHE E STËR-VITJES. Strukturë e veçantë dhe e rëndësishme e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), e cila përpunon dhe harton koncepte doktrinare bazë të organizimit dhe përdorimit të FSK-së, planifikon, organizon dhe realizon përgatitjen, arsimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të pjesëtarëve të FSK-së, mbështet Komandën e Forcave Tokësore, Brigadën e Mbështetjes Operacionale, Brigadën e Reagimit të Shpejtë dhe Ministrinë e FSK-së në zhvillimin e planeve dhe koncepteve të edukimit, trajnimit dhe stërvitjes ushtarake. (Demë Hoti)

KOMANDANTËT E KFOR-it (1999-2015). Në funksion të ushtrimit të mandatit të KFOR-it, trupat e NATO-s në Kosovë janë udhëhequr nga një komandant, i cili zëvendësohet me sistem rotacioni. Në periudhën nga viti 1999 deri më 2013, njëzet e një komandantë, me origjinë nga shtete të ndryshme kontribuuese udhëhoqën KFOR-in. Komandat i parë i KFOR-it, që udhëhoqi edhe hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, ishte gjenerali britanik Sir Michael Jackson. Komandatët e tjerë të KFOR-it, sipas radhës së shërbimit, përfshirë vendin e origjinës dhe kohën në shërbim, ishin gjeneralët: Klaus Reinhardt nga Gjermania (8 tetor 1999-18 prill 2000), Juan Ortuno nga Spanja (18 prill 2000-16 tetor 2000), Carlo Cabigiosu nga Italia (16 tetor 2000-6 prill 2001), Thorstein Skiaker nga Norvegjia (6 prill 2001-3 tetor 2001), Marcel Valentin nga Franca (3 tetor 2001-4 tetor 2002), Fabio Mini nga Italia (4 tetor 2002-3 tetor 2003), Holger Kammerhoff nga Gjermania (3 tetor 2003-1 shtator 2004), Yves de Kermabon nga Franca (1 shtator 2004-1 shtator 2005), Giuseppe Valotto nga Italia (1 shtator 2005-1 shtator 2006), Roland Kather nga Gjermania (1 shtator 2006- 31 gusht 2007), Xavier de Marnhac nga Franca (31 gusht 2007-29 gusht 2008), Giuseppe Guy nga Italia (29

gusht 2008-8 shtator 2009), Markus Bentler nga Gjermania (8 shtator 2009-1 shtator 2010), Erhard Buhler nga Gjermania (1 shtator 2010-9 shtator 2011), Erhard Drews nga Gjermania (9 shtator 2011-7 shtator 2012) dhe Volker Halbauer nga Gjermania (7 shtator 2012-6 shtator 2013), Salvatore Farina nga Italia (6 shtator 2013-3 shtator 2014) dhe Francesco Paolo Figliuolo nga Italia (3 shtator 2014-27 gusht 2015) dhe Guglielmo Luigi Miglietta nga Italia (gusht 2015-). (Qerim Qerimi)

KOMANI Qazim (1895-1950). Ushtarak, komandant i Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës. Lindi në Gjakovë. Shkollimin e mbaroi në Gjakovë dhe në Tiranë. Studioi në Kolegjin “San Demetrio Corona” të Italisë për oficer këmbësorie. Një kohë shërbeu në ushtrinë shqiptare, më pas ishte arsimtar mësimdhënës në Shkollën Normale të Elbasanit. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste internohet në Itali. Nga shkurti deri në maj të vitit 1944 ishte komandant i sektorit “Kosova” të Ushtrisë Shqiptare me gradën e kolonelit. U shqua si drejtues i luftimeve kundër forcave çetnike-partizane në shumë vija kufitare dhe organizator i formacioneve vullnetare. Nën drejtimin e tij ishin regjimenti i Pejës dhe regjimenti i Prishtinës. Pas suprimimit të sektorit “Kosova” u rikthye në Tiranë. Pas luftës u arrestua nga regjimi komunist në Shqipëri dhe në fillim të vitit 1946 iu dorëzua autoriteteve jugosllave. Vdiq nga torturat në Burgun e Mitrovicës së Sremit. (Sulltane Ukaj)

KOMASACIONI. Grupimi i parcelave të shpërndara me qëllim të shfrytëzimit më racional të tokës bujqësore. Përmes komasacionit mundësohet aplikimi më i mirë i masave agroteknike dhe arritja e efekteve më të larta ekonomike. Gjithashtu, rregullohet edhe rrjeti i rrugëve, që mundëson qasje në çdo parcelë. Deri më tani me komasacion në Kosovë janë përfshirë vetëm 26,565 ha, kryesisht në zonat që janë nën sistemet e ujitjes (105 zona kadastrale). Kjo sipërfaqe përfshin më pak se 10% të tokës bujqësore. Për Kosovën vazhdimi i punëve në komasacion është me rëndësi, për faktin se madhësia e fermave është shumë e vogël dhe e shpërndarë në disa parcela, si dhe do të ndihmonte në rregullimin e çështjeve pronësore që kanë të bëjnë me tokën bujqësore. (Skender Kaçiu).

KOMBINATI “TREPÇA”. Kombinati mine-rar-metalurgjik-kimik “Trepça” bënte pjesë në grupin e ndërmarrjeve më të mëdha në ish-Federatën Jugosllave. Ishte prodhuesi më i



KOMBINATI TREPÇA

madh i plumbit dhe zinkut në Europë. Skema organizative e kombinatit ishte shtrirë në 16 komuna, në dy republika dhe në dy krahina autonome të ish-Jugosllavisë. Në “Trepçë” dhe në malet përreth, gjeologët e parë anglezë ndeshen që në vitin 1924, ndërsa shoqëria aksionare “Trepça Mine Limited” është regjistruar në dhjetor të vitit 1927. Deri në vitin 1960 “Trepça” ishte e përbërë nga miniera e Stantërgut dhe repartet në Zveçan (flotacioni, shkriticja e plumbit, rafineria, termocentrali etj.), kurse më 1962 në kuadër të “Trepçës” hyjnë të gjitha minierat e plumb-zinkut të Republikës së Serbisë dhe më gjerë. Më vonë zhvillohen edhe forma të tjera të integrimi dhe të bashkëpunimit afarist me më se 11 ndërmarrje të republikave dhe krahinave të Jugosllavisë. Kështu, skema organizative e kombinatit “Trepça” në vitin 1977 përfshinte 26 ndërmarrje prodhuese me mbi 25 mijë të punësuar. Kompleksi industrial i “Trepçës” ishte ndërmarrje e përbërë ekonomike për prodhimin e plumbit dhe të zinkut si prodhime bazë, si dhe të metaleve të tjera shoqëruese (Ag, Au, Bi, Sb, Cd). Sipas lëmenjve, në kombinatin “Trepça” në vitin 1987 ishin të përfshira xehetaria me 20.9%, metalurgjia me 19.33%, prodhimi i akumulatorëve me 17.33%, përpunimi i metaleve me 17.63%, prodhimet kimik me 5.24% dhe veprimtaritë e tjera 19.57%. Në vitin 1983 “Trepça” eksportoi mallra me vlerë 103 milionë dollarë, duke u radhitur në vendin e 5-të të eksportuesve më të mëdhenj në ish-Jugosllavi. Për 58 vjet të punës


prodhuese, "Trepça" ka prodhuar 33 milionë tonë xeherorë me një përmbajtje mesatare 9.0% Pb+Zn. Përveç kësaj, në metalurgjinë e "Trepçës", në kohëzgjatje të ndryshme, u prodhuan këto sasi të metaleve të çmueshme: argjendi (Ag) 4,572 tonë për 45 vjet; ar (Au) 8,675 kg për 34 vjet; bizmut (Bi) 4,115 tonë për 43 vjet dhe kadmium (Cd) 1,655 tonë për 20 vjet. Në periudha kohore të ndryshme, "Trepça" ka pasur rezerva të llojllojshme të xeherorëve të Pb-Zn si për nga sasia, ashtu edhe për nga përmbajtja e metaleve. Rezervat A+B+C₁ e xeherorëve të Pb-Zn të tri grupimeve të minierave (Stantërg, Kishnicë-Novobërdë dhe Kopaonik), të vërtetuara me 1986, ishin 37.7x10⁶ t, me përmbajtje mesatare Pb=4.28%, Zn=3.00% dhe Ag=75g/t. Ndërsa prodhimi i planifikuar për vitin 1986 ishte 1.6x10⁶ t xeherorë. Shërbimi gjeologjik i kërkim-zbulimeve të "Trepçës" ishte ndër më të mirët e më të suksesshmit në ish-Jugosllavi, i cili vite me radhë siguronte bazën e lëndës minerare të "Trepçës". Fabrikat e pasurimit në sistemin e kombinatit të "Trepçës" ishin ndërtuar veç e veç, për secilin grup të minierave me këto aftësi: 1) flotacioni në "Tunel" i minierës Stantërg, me aftësi në fazën I prej 1 milion t/v xeherorë, kurse në fazën II 1.5 milionë t/v; 2) flotacioni i Badofcit i grup-minierave Kishnicë-Novobërdë me aftësi 1.1 milionë t/v xeherorë dhe 3) flotacioni në Leposaviq i grup minierave të Kopaonikut me aftësi 0.5 milionë tonë xeherorë. Zhvillimi i metalurgjisë së plumbit në "Trepçë" e ka zanafillën që në vitin 1940, kur u ndërtua shkitorja e Plumbit në Zveçan me aftësi 28,000 t/vit Pb lëndor. Pastaj në kohë të ndryshme (1950, 1967 dhe 1982) u kryen rikonstruktive dhe zgjerime, në mënyrë që të arrinte aftësinë maksimale prodhuese prej 175,000 t/vit Pb lëndor, ndërsa aftësia e shkrites ishte 49.4-79.2%. "Trepça" nuk ka pasur teknologji për përfitim e metaleve e elementeve të rralla (In, Gr, Te, Ta, Se). Ndërkaq, elektroliza e zinkut u ndërtua në Mitrovicë në vitin 1976, me aftësi prodhuese 30,000 t/v Zn elektrolit dhe 80 t/v Cd. Pas një dekade të punës, teknologjia e kësaj elektrolize u vjetrua, kështu që kishte shumë arsye për rikonstruktimin dhe zgjerimin e saj. Elektroliza e re u përrua në vitin 1986 me aftësi 50,000 t/v Zn elektrolit, oksid Zn 5,000 t/v, acid sulfurik 140,000 t/v, kadmium 368 t/v etj. Industria kimike e "Trepçës" prodhonte superfosfat pluhur (250,000 t/v), superfosfat

granulat (100,000 t/v), superfosfat SPT (100,000 t/v), plehra komplekse NPK (144,000 t/v), acid fosforik (50,000 t/v) etj. Në "Trepçë" ishte arritur një shkallë e lartë e finalizimit të metaleve që prodhonte metalurgjia. Në vitin 1968 u bë përrurimi i Fabrikës së Akumulatorëve në Mitrovicë me aftësi 6000 t/v akumulatorë "starterë", ndërsa zgjerimi i prodhimit përfshiu shtimin e aftësive ekzistuese dhe ndërtimin e atyre të reja të baterive industriale dhe të motoçikletave, duke u rritur aftësia prodhuese në mbi 35,000 t/v. Fabrika për prodhimin e baterive Ni-Cd prodhonte 1 milion copë bateri, që më vonë (1989) shtoi prodhimin në 110%. Fabrika e akumulatorëve në Sombor (Serbi) kishte një prodhim prej 8,000 t/v akumulatorë. Fabrikat tjera në kuadër të sistemit të integruar të "Trepçës", të cilat kanë pasur për bazë finalizimin e metaleve nga metalurgjia e "Trepçës", ishin: Fabrika e llamarinës së zinkuar në Vushtrri me aftësi 120,000 t/v llamarinë të zinkuar; Fabrika "Metaliku" në Gjakovë, që prodhonte enë të zinkuara e të teflonit, litar dhe gypa me standarde të ndryshme, rrjeta e armatura, gypa të zinkuar dhe prodhime kordi; Fabrika për përrpunimin e metaleve të çmueshme "Famipa" në Prizren, e cila në programin e saj të prodhimeve kishte artikuj ndër më të ndryshmit; Fabrika e pajisjeve të procesit; Fabrika e municionit të gjuetisë në Skënderaj dhe Fabrika e ngjyrave dhe e llaqeve "Ekstra" në Vushtrri. Pas vitit 1999 objektet e kombinatit "Trepça" u ndanë në pjesën veriore dhe jugore. U formua kombinati "Trepça" në kuadër të UNMIK-ut, e më vonë ky kombinat kaloi në administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe në fund në administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Në vitin 2016 Qeveria e Kosovës nxori një ligji të veçantë për "Trepçën", me të cilin krijohen parakushtet ekonomike, pronësore dhe juridike për rimëkëmbjen e kapaciteteve prodhuese të këtij kombinati. (Minir Dushi)

KOMBINATI BUJQËSOR-INDUSTRIAL "AGROKOSOVA". Sistem i integritit të bujqësisë, të industrisë përrpunuese, të tregtisë, të shërbimeve profesionale, i cili funksionoi deri në vitet '90 të shekullit të kaluar. Integritet ishin të formës horizontale në tërë Kosovën dhe vertikale në të gjitha fazat e prodhimit, të përrpunimit dhe të tregtimit. Në kuadër të sistemit të "Agrokosovës" ishin mbi 17 organizata

bazë agroindustriale në të gjitha komunat më të mëdha, pastaj sektori i kooperimit përmes Lidhjes së Kooperativave të Kosovës, tregtia në bujqësi, sistemi bankar në sektorin e bujqësisë, zhvillimi i shkencës etj. Roli i “Agrokosovës” ishte në koordinimin e aktiviteteve zhvillimore në mes të anëtarëve, përfaqësimi në tregjet e jashtme, shfrytëzimi më racional i resurseve natyrore, financiare dhe njerëzore etj. Pas aplikimit të masave të dhunshme të Serbisë në ekonominë dhe institucionet e Kosovës, në fillim të viteve ‘90 filloi degradimi edhe i kompleksit agroushqimor. Sipërfaqet e mëdha bujqësore filluan të mbesin djerrë, pemishtet, vreshtat dhe kapacitetet për mbarështim të kafshëve u lanë pas dore. Edhe industria agroushqimore degradoi ndjeshëm. Shumica e kapaciteteve u mbyllën dhe u shkatërruan. (Halim Gjergjizi)

KOMBINATI I DUHANIT, GJILAN. Daton nga viti 1943. Në fillim bënte grumbullimin e duhanit. Në vitin 1953 filloi prodhimin e cigareve klasike “Drava”, “Morava”, “Bozhur”



KOMBINATI I DUHANIT, GJILAN

dhe “Zeta”. Në vitin 1960 filloi prodhimin e cigareve me filtër. Fabrika e re me teknologji moderne u ndërtua në vitin 1972, kurse më 1981 u nënshkrua kontrata me “Dunhill King Size”, i cili ishte prodhues i madh me famë botërore. Kapaciteti i prodhimit të cigareve “Dunhill” në Gjilan ishte 400 tonë në vit. Kishte të punësuar rreth 550 punëtorë, ndërsa merrte në punë edhe 600 punëtorë sezonalë. Punktet e grumbullimit të duhanit ishin në Gjilan, në Viti dhe në Kamenicë, ku grumbulloheshin rreth 2,200 tonë duhan në vit. Aftësia prodhuese e Kombinatit të Duhanit në vitin 1981 arriti 1,650 tonë cigare në vit. Cigaret e Gjilanit janë shitur në mbarë ish-Jugosllavinë, ndërsa për eksport

në BRSS ishin 500 tonë në vit cigare “Oscar”. Kombinati kishte punktet e veta edhe në Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë. Duhani si lëndë e parë është eksportuar në Gjermani, Austri, Angli (sidomos duhani “Virxhinia”, që kultivohej në komunën e Gjakovës). Kombinati gjendet në fazën e konsolidimit, pas riprivatizimit nga “Premium Tobacco Group”. (Fehmi Krasniqi).

KOMBINATI I LËKURË-KEPUCËVE, PEJË.

U themelua në vitin 1959 për përpunimin e lëkurës së imët dhe të trashë, me aftësi të përpunimi 4,600 tonë të lëkurës në vit. Një aftësi e këtillë ishte bazë e mirë për sigurimin e lëndës së parë për prodhimin e këpucëve, për prodhimin e konfeksionit (xhupa, jelekë, mantele etj.) dhe për prodhimin e peliçeve (gëzofit). Aftësia vjetore e prodhimit në të tri vijat teknologjike ishte: fabrika e këpucëve (1960) prodhonte rreth 1,5 milionë palë këpucë në vit, fabrika e konfeksionit (1963) prodhonte rreth 30,000 njësi veshjeje në vit dhe fabrika e peliçeve (nga viti 1963) arrinte të prodhonte 500,000 m² gëzof në vit. Në të tri njësitë, kombinati kishte të punësuar rreth 1,800 punëtorë dhe ishte përpunuesi i vetëm i lëkurës dhe i gëzofit në Kosovë. Objektet dhe lokacioni i kombinatit përfshijnë një sipërfaqe prej rreth 11 hektarësh, ku vetëm ndërtesat kanë një sipërfaqe prej 46,600 m². Tri njësitë e ndara kanë lidhje të veçanta me shërbime publike dhe leje nga komuna për rrugë të veçanta për hyrje-dalje. Prodhimet e kombinatit të lëkurë-këpucëve të Pejës janë shitur në tërë ish-Jugosllavinë dhe në shtetet e Europës (Rusi, Gjermani, Itali, Austri etj.). Fabrika është privatizuar më 2006 dhe ende nuk ka filluar prodhimin. (Musa Rizaj).

KOMBINATI I TEKSTILIT “EMIN DURAKU”, GJAKOVË.

Ndërtimi filloi në vitin 1958 dhe prodhimi i pëlhurave të para nga pambuku në repartin e vektarisë filloi në vitin 1961. Një vit më pas u aktivizua edhe reparti i përpunimit. Më vonë ndërtohet edhe reparti i tjerres, me të cilin rrumbullakohet cikli i prodhimit të pëlhurave nga pambuku. Pajisjet dhe teknologjia ishin nga Gjermania, Franca, Belgjika, Danimarka etj. Krahas ndërtimit të kombinatit, filloi edhe përgatitja e kuadrit profesional. Investimet e mëvonshme u orientuan në modernizimin e pajisjeve teknologjike për prodhim të cilësisë së lartë,

sikurse janë tjerri gjysmë i krehur dhe i krehur, kadifeja (kord-samt) dhe kadifeja e rrafshët (samt), e cila prodhohej vetëm në këtë kombinat në mbarë ish-Jugosllavinë. Në vitin 1982 u bë integrimi i kombinatit “Emin Duraku” dhe i uzinës së konfeksionit “Jatex”, që me 6,000 të punësuarit e bëri kombinatin ndër më të mëdhenjtë në ish-Jugosllavi. Në “Jatex” asokohe filloi rikonstruktimi i procesit të prodhimit, duke kaluar në prodhimin e konfeksionit të rëndë dhe të konfeksionit të lehtë, më ç’rast u përmyll cikli i prodhimit nga lënda e parë (pëlhura) e deri te prodhimi final (konfeksioni). Në vitin 1985 fillon ndërtimi i repartit për prodhimin e lëkurës artificiale nga poliuratanit (koagullati), lëndë e kërkuar nga prodhuesit e këpucëve, konfeksioneve, çantave etj. Kjo ishte sfida e fundit e zgjerimit të kombinatit për prodhimin e produkteve të llojllojshme. Pas vitit 1990 fillon rënia e kombinatit, kurse shkatërrimi i tërësishëm ndodhi pas vitit 1999. (Masar Kusari)

KOMBINATI I TEKSTILIT “INTEGJ” GJILAN. I themeluar në vitin 1953, në fillim ishte një punëtori me makina thurjeje, pastaj u zhvillua në një gjigant, i njohur për prodhime të tek-



KOMBINATI I TEKSTILIT “INTEGJ”, GJILAN

stilit në ish-Jugosllavi dhe më gjerë. Kombinati me aftësi të plotë prodhuese filloi në mesin e viteve ’70, me nxjerrjen në treg të tepihëve “tafting”. Nga viti 1986 filloi prodhimi i tepihëve për vettura, me kapacitet prej 350,000 m² në vit dhe në fund të vitit 1989 filloi prodhimi i tjerit për tepihë me kapacitet prej 2,250 tonë në vit. Në vitin 2006 kombinati i tekstit “Integj” u privatizua nga “Albimi L.T.D” dhe u riemërua “New Co Integj”. Kompania e re filloi implementimin e projektit për rinovimin dhe modernizimin e

fabrikës, me një investim të madh në digjitalizimin e makinave dhe të procesit të prodhimit të tepihëve, duke iu përshtatur kërkesave të tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Pas këtyre investimeve, kompania e re më 2007 filloi prodhimin e tepihëve me sistem digjital dhe tjerri shumë cilësor. Investimet e bëra në aftësi prodhuese llogariten si një nga më të lartat në rajon në fushën e prodhimit të qilimave në vlerën prej rreth 2,700 tonë fije, si dhe 481,000 m² tepiha në vit. Prodhimet e “New Co Integj” i dedikohen tregut të vendit, por një pjesë e prodhimit eksportohet në Belgjikë, Gjermani, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi etj. (Musa Rizaj).

KOMERCIALIZIMI. Formë e qiradhënies së asetëve të ndërmarrjeve shoqërore. Përmes kësaj metode u janë dhënë në shfrytëzim ndërmarrjeve private asetet e ndërmarrjeve shoqërore për një periudhë të caktuar kohore. Procesi i komercializimit ishte përpjekja e parë në Kosovën e pasluftës për të futur sektorin privat në ndërmarrjet shoqërore. Kjo metodë është përdorur si masë e përkohshme për të siguruar rritjen e investimeve, ndërprerjen e zhvleftësimit të pronës shoqërore, në rrethanat e mungesë së definimit rreth të drejtave pronësore. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), mes tjerash, ka adoptuar këtë metodë, në mënyrë që t’u shmanget çështjes së pronësisë së ndërmarrjeve shoqërore, e cila, sipas këtij misioni, ka qenë e lidhur me statusin e Kosovës. Nëpër procesin e komercializimit në Kosovë kanë kaluar 16 ndërmarrje shoqërore, të cilat janë dhënë në shfrytëzim për një periudhë 10-vjeçare. Ky proces është dëshmuar si shumë i ngadalshëm dhe kompleks, prandaj është zëvendësuar me procesin e privatizimit të filluar në vitin 2002. (Alban Hashani)

KOMISIJA LETRARE E SHKODRËS (1916-1918). Institucion shkencor gjuhëtarësh dhe shkrimtarësh, i ngritur në Shkodër më 1 shtator 1916, me nismë të Luigj Gurakuqit, në Drejtorinë e Arsimit, që punoi me ndërprerje deri më 22 maj 1918 dhe arriti për herë të parë të standardizonte gjuhën shqipe mbi bazën e elbasanishtes. U mor me çështje të drejtshkrimit, të terminologjisë administrative gjyqësore dhe shkollore (gjuhësore e matematikore), si dhe me përgatitjen e teksteve mësimore për nevojat e shkollës shqipe.

Qëllimi i tij ishte që të çonte më tej zgjidhjen e problemit të gjuhës letrare shqipe dhe të arsimit shqip, pas Kongresit të Manastirit (1908). Kjo ngjarje shkencore e kulturore u mbështet nga konsulli i përgjithshëm i Austro-Hungarisë. Në të morën pjesë Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani, Ambroz Marlaskaj, Ndue Paluca, Sotir Peci, Hafiz Ali Korça, Vinçenc Prenushi, Luigj Naraçi, Sali Nivica, Josif Haxhimima, Rajko Nahtigal, Maksimilian Lamberc, të cilët e vunë punën e Komisionit Letrare të Shkodrës (KLSH) në shërbim të çështjes kombëtare. Kryetar i KLSH-së u caktua dr. Gjergj Pekmezi. Më vonë kryetar i saj u zgjodh Luigj Gurakuqi. KLSH-ja e kishte propozuar variantin e gegërishtes së mesme (elbaskanishten) për bazë të gjuhës letrare, me arsyetimin se ky variant, duke qenë gjeografikisht në jug të gegërishtes, pra në kufi me toskërishten, ishte më i afërt në aspektin lingistik për të dy variantet. Më 3 janar 1917, KLSH-ja miratoi për herë të parë kodin drejtshkrimor “Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme”, i cili u botua si broshurë e veçantë e më pas edhe në shtypin e kohës dhe pati si themel dialektin e Elbasanit me disa ndryshime. Ndër vendimet e rëndësishme të saj ishte që ortografia e shqipes të mbështetej kryesisht në parimin fonetik, gërshtuar edhe me parimin morfologjik dhe parimin historik-traditional. Ortografia e Komisionit Letrare Shqipe e Shkodrës është drejtshkrim i parë në historinë e gjuhës letrare shqipe, që u hartua nga një grup kolektiv dhe u miratua në një tubim të rëndësishëm shkencor. Vendimet e KLSH-së i miratoi Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe i miratoi për zbatim Qeveria Shqiptare në janar të vitit 1923. Kjo gjuhë letrare, me rregullat për drejtshkrimin e shqipes të propozuara nga Komisioni Letrare, ka qenë gjuhë zyrtare e Shqipërisë në periudhën 1923–1945. (Shkumbin Munishi)

KOMISIONI I BADINTERIT PËR ISH-JUGOSLLAVINË (1991-1993). Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës për Jugosllavi, i themeluar nga Këshilli i Ministrave i Bashkimit Europian. Përbëhej nga pesë anëtarë (kryetarë të gjykatave kushtetuese nga vendet anëtare të BE-së), me kryetar gjyqtarin francez, Robert Badinter. Si detyrë parësore Komisioni kishte përgatitjen e mendimeve për Konferencën

për ish-Jugosllavinë. Komisioni lëshoi gjithsej 15 mendime juridike për shpërbërjen e RSFJ-së, për të drejtën për vetëvendosje, kufijtë, zgjidhjen e çështjeve të suksesimit etj. Në asnjërin nga këto mendime, Komisioni nuk kishte dhënë qëndrimin e vet juridik sa i përket Kosovës. Komisioni nuk ia njohu Kosovës të drejtën për vetëvendosje, siç ua kishte njohur ish-republikave jugosllave dhe, rrjedhimisht, as të drejtën e Kosovës në suksesionin juridik-ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë (RSFJ), duke e lënë atë brenda juridiksionit serb. Ky Komision arbitrar njëjtte si titullar të këtij procesi shtetkrijues vetëm republikat: “U takon republikave t’i zgjidhin problemet e trashëgimisë së shtetit”, shprehej Komisioni i Badinterit dhe theksonte se “kufijtë e mëparshëm të brendshëm të republikave bëhen kufij ndërkombëtarë”. (Ilir Dugolli)

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIEVE (KPM). Agjenci e pavarur e Kosovës, e themeluar më 2005, që merret me rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. KPM-ja është organ i pavarur, i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa sipas ligjit ka përgjegjësinë për të licencuar transmetuesit publikë dhe privatë, të përcaktojë dhe të zbatojë politikën e transmetimit si dhe të rregullojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale. Përgjegjësi e KPM-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet ndërkombëtare. KPM-ja e ka obligim të zbatojë politika të transmetimit në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian, duke respektuar plotësisht demokracinë, sundimin e ligjit, mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audiovizuale. KPM-ja është e përfshirë në përgatitjet për transmetim digjital në Republikën e Kosovës. (Artan Krasniqi)

KOMISIONI PËR GJUHË E LETËRSI I PLEQËSISË PËR ARSIMIKSA TË KOSOVËS DHE TË METOHISË. Komision që kishte për qëllim zgjidhjen e disa problemeve gjuhësore për shqiptarët në ish-Jugosllavi. Komisioni

ishite ngritur në kuadër të Pleqësisë për Arsim e Kulturë të Këshillit Populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë. Në mbledhjen e datës 30 dhe 31 maj 1962 u diskutuan dy referate, njëri i "gjuhëtarëve të Prishtinës" (Hasan Vokshi, Sulejman Drini, Sali Kolgeci dhe Demush Shala) dhe tjetri i ashtuquajtur i "gjuhëtarëve të Beogradit" (Idriz Ajeti, Vojislav Dançetoviq, Mehdi Bardhi e Anton Çetta). Kjo ishte mbledhje e dytë për çështje të gjuhës shqipe në Kosovë, pas asaj të vitit 1952. Atëbotë, me nismën e Këshillit për Arsim e Kulturë të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, në Prishtinë, më 14 e 15 nëntor 1952, u mblodhën "disa puntorë e intelektualë shqiptarë të gjuhës dhe të letërsisë dhe kanë diskutuar mbi nevojën e zgjidhjes së disa problemeve gjuhësore për lavrimin e matejshëm të gjuhës dhe të kulturës së pakicës shqiptare në Jugosllavi. Në mbledhje pjesëmarrës kanë qenë: M. Hoxha, I. Shaqiri, E. Nimani, A. Gashi, K. Shiroka, I. Pula, S. Riza, V. Dançetoviq, P. Janura, Z. Rexha, M. Peza, I. Ajeti, H. Sulejmani, E. Mekuli, H. Vokshi, H. Kaleshi, S. Kolgeci etj. Më 1961, Komisioni për Gjuhë dhe Letërsi i Pleqësisë për Arsim kishte caktuar një komision për ta rishikuar ortografinë. Ky Komision përbëhej nga: Idriz Ajeti, Hasan Vokshi, Sulejman Drini, Mehdi Bardhi e Latif Mulaku. Projekti i Komisionit u botua në "Rilindje" në disa numra në dhjetor të vitit 1962 dhe janar të vitit 1963. Kryetar i Pleqësisë për Arsim e Kulturës i Kosovë dhe i Metohisë ishte Kolë Shiroka. Më 1968 Komisionit i shtohen edhe përfaqësues të shqiptarëve nga viset e tjera të ish-RSFJ-së: Murat Isaku dhe Xhevat Gega (Maqedoni) dhe Luc Lucaj (Mali i Zi). (Shkumbin Munishi)

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I KOSOVËS (KQZ). Institucion i pavarur kushtetues. KQZ-ja përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon veprimet e procesit zgjedhor ose referendume dhe bën shpalljen e rezultateve të tyre në Republikën e Kosovës. KQZ-ja u themelua në vitin 2001, me përkrahjen e misionit të OSBE-së dhe Zyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ndërkaq sekretariati i tij u themelua në vitin 2003. KQZ-ja përbëhet nga 11 anëtarë dhe ka kryesuesin e tij, të cilin e emëron presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të gjykatave me juridiksion apeli me mandat 7-vjeçar. Sekretariati

i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është organizim operativ, administrativ dhe teknik i shërbimit civil të Kosovës, që ndihmon KQZ-në. Në kuadër të sekretariatit të KQZ-së vepron Zyra për regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e tyre, si dhe komisionet komunale zgjedhore (KKZ). (Mazllum Baraliu)

KOMITETI "BASHKIM E PËRPARIM" (1889) Organizatë politike që angazhohej kundër regjimit absolutist të sulltanit Abdyl Hamiti II. Organizata "Bashkim e Përparim" (Ittihad ve Terakki) tubonte rreth vetes intelektualë përparimtarë me koncepte të avancuara politike. Komiteti u formua në maj të vitit 1889, si organizatë gjysmë e fshehtë. Njëri nga nismëtarët e kësaj organizate ishte Ibrahim Temo nga Struga. Anëtarët e komitetit, duke qenë të rrezikuar, shumicën e aktiviteteve e zhvillonin jashtë territorit të Perandorisë Osmane. Ishte grupim politik i ndikuar edhe nga idetë përparimtare të Europës. Organizata kërkonte rivendosjen e Kushtetutës së vitit 1876, si parakusht për rënien e sistemin absolutist të ndërtuar prej kohësh në Perandorinë Osmane. Pikë e përbashkët ndërmet kësaj organizate dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishte lufta kundër sistemit absolutist të sulltanit. Ndërsa turqit e përfshirë në këtë organizatë kërkonin ndërrimin e sistemit hamitist, shqiptarët besonin se me përmbysjen e sulltan Abdyl Hamitit II do të krijoheshin kushte dhe rrethana për bashkimin e vilajeteve shqiptare dhe formimin e shtetit autonom. Në këtë lëvizje të "turqve të rinj" morën pjesë edhe personalitete të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si: I. Qemali, D. Hima, J. Erebara, H. Ohri, H. K. Prishtina etj. Në vitin 1902, në Kongresin e Parisit, shqiptarët e përfshirë në këtë lëvizje kërkuan t'u njiheshin të drejtat kombëtare. Komiteti "Bashkim e përparim" organizoi dhe udhëhoqi revolucionin xhonturk në vitin 1908. (Frashër Demaj)

KOMITETI "SHQIPËRIA E LIRË" (1949-1991). Organizatë politike me program nacionalist, që veproi në shtetet e Perëndimit. U formua në gusht të vitit 1949 në Romë. Përbëhej nga veprimtarë të organizatave të qëndresës nacionaliste, të cilët kishin vepruar në Shqipëri dhe Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, si: Mithat Frashëri, kryetar i "Ballit Kombëtar" (që u zgjodh kryetar i Komitetit); Abaz Kupi,

kryetar i organizatës Lëvizja e Legalitetit; Seit Kryeziu, kryetar i Partisë Katundare etj. Komiteti luajti rol me rëndësi për rekrutimin e diversantëve shqiptarë për misionet anglo-amerikane për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri. Pas shpërndarjes së tij në vitin 1953, u formua Komiteti II me të njëjtin emër, me kryetar Hasan Dostin, me pjesëmarrje më të gjerë të mërgatës politike shqiptare dhe me veprimtari më të avancuar politike. Në vitin 1956, Komiteti u shpërbë, për t'u riformuar në Nju-Jork për të tretën herë. Komiteti nxori gazetën "Shqipëria e Lirë", kurse në fund të vitit 1956 "Buletin e ri shqiptar", që botohej shqip dhe anglisht. Komiteti kishte përfaqësuesin e vet në Asamblenë e Kombeve të Robëruara, i cili u zgjodh dy herë kryetar e nënkryetar i kësaj asambleje. Organizata u angazhua për sistemimin në SHBA të 15,000 refugjatëve shqiptarë, që jetonin në kampe në Itali, Greqi dhe Austri. Komiteti organizoi tubime dhe konferenca për informimin e opinionit publik lidhur me situatën politike në Shqipëri e Kosovë. Komiteti ndërpreu veprimtarinë në vitet '90, pas rënies së komunizmit në Shqipëri (Muhamet Shatri).

KOMITETI I BRUKSELIT (KOMITETI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË). Organizatë e emigracionit shqiptar në Bruksel, që kishte për qëllim denoncimin e dhunës shtetërore mbi shqiptarët në ish-Jugosllavi. Pas vitit 1981 në Kosovë dhe në mbarë ish-Jugosllavinë ndodhën shkelje masive të të drejtave të njeriut, që bashkë me një fushatë të egër antishqiptare kishte për qëllim suprimimin e autonomisë së Kosovës. Në një rrethanë të këtyllë, në mërgatën kosovare në shtetet perëndimore u shtrua nevoja e denoncimit të kësaj dhune shtetërore që ushtrohej në Kosovë. Për këtë qëllim, në prill të vitit 1983, Enver Hadri me një grup bashkatdhetarësh në Bruksel themeluan Komitetin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë. Komiteti organizoi nënshkrimin e peticioneve, përgatitjen e dosjeve, vënien e kontakteve zyrtare me personalitete të ndryshme, me autoritetet belge dhe me organizatat e institucionet ndërkombëtare, sidomos me përfaqësues të Këshillit të Europës dhe të Parlamentit Europian. Rëndësi të posaçme Komiteti i kushtoi bashkëpunimit me mediet e huaja, duke organizuar konferenca të

rregullta për shtyp. Në fund të viteve '80, me ashpërsimin e krizës në Kosovë, Komiteti u bë zëdhënës i çështjes së Kosovës në Bruksel. Me aktivitetin e këtij Komiteti lidhet edhe aprovimi i rezolutës së parë të Parlamentit Europian kushtuar Kosovës (13 prill 1989) dhe më pas i rezolutës së 15 shkurtit 1990, me të cilën denoncohej politika e Serbisë në Kosovë, dënohej vrasja e 30 demonstruesve shqiptarë, kërkohej lirimi i të burgosurve politikë etj. Punës së Komitetit i duhet atribuar edhe vizita e një delegacioni të Parlamentit Europian në Kosovë (qershor 1989), pastaj raporti e delegacionit të Parlamentit Europian për marrëdhënie me Jugosllavinë i datës 15 mars 1990 etj. (Muhamet Shatri)

KOMITETI I RINISË NACIONALISTE PËR MBROJTJEN E KOSOVËS (1944). Organizatë e rinisë shqiptare të Kosovës për mbrojtjen e vendit nga sulmet serbe. Komiteti u formua në Prishtinë në fillim të shtatorit 1944. Në tubimin themelues kryetar i Komitetit u zgjodh Adem Selimi, si dhe u formuan batalionet e të lindurve nga 1910-1917 dhe batalionet e të lindurve nga 1917-1927. Pjesëtarët e këtij komiteti vinin shami të kuqe me germa të zeza, në të cilat shkruhej: Mbrojtja e Kosovës. Komiteti kishte seksionin ushtarak, të propagandës, atë financiar dhe seksionin e transportit. Në Ferizaj dhe në Gjilan u formuan komitetet e rretheve me model të njëjtë, sikurse Komiteti i Qarkut të Prishtinës. Kryetar i seksionit për financa e furnizim u zgjodh Shahsivar Aliu. Seksioni ushtarak duhej të mobilizonte dhe të organizonte ushtrinë, kurse kryetar i tij u emërua Abdyl Henci. Detyrën drejtuesve të seksionit të propagandës e kryenin Shemsedin Venderesi dhe Luan Gashi, kurse kryetar i seksionit të transportit u zgjodh Salih Vala-Siçani. Në fund të shtatorit të vitit 1944 nga shqiptarët e rrethit të Prishtinës, të Llapit, të Ferizajt dhe të Gjilanit u formuan 4 batalione ushtarake me nga 300 të mobilizuar, ndërsa komandantë të tyre ishin Sali Vala-Siçani, Ibush Ibrahim, Selim Maçastena dhe Shahsivar Aliu, i cili ishte edhe komandant i të gjitha batalione. Në secilin batalion kishte nga katër çeta, tri të prapavijës dhe një mitraljer, nga dy mortaja dhe nga katër-pesë mitraloza. Gjatë muajit tetor dhe nëntor të vitit 1944 këto batalione luftuan në vijën Kërshi i Uglarit-Kikë, kundër forcave të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. (Izber Hoti)

KOMITETI I STAMBOLLIT (1878). Organizatë e shqiptarëve në Stamboll, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare në Perandorinë Osmane. Sipas burimeve osmane, Komiteti e kishte filluar aktivitetin në mars të vitit 1877, në kushte të ilegalitetit, në kohën kur u zgjodhën shumë deputetë shqiptarë në parlamentin osman. Sipas të njëjtave burime, me iniciativën Abdyl Frashrit dhe Sami Frashërit, në mars të vitit 1878 ishte themeluar kjo organizatë e shqiptarëve, e cila mori karakterin e një organi zyrtar shqiptar në emigrim me emrin “Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësive Shqiptare”. Kryetar i këtij Komiteti u zgjodh Abdyl Frashëri, ndërsa anëtar të tij ishin: vëllezërit Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Seit Toptani etj. Po ashtu, anëtarë të këtij komiteti ishin edhe shumë shqiptarë të Parlamentit Osman, si Imer Prizreni, Zenel Abedin Prishtina, Mustafë Kosova etj. Sipas burimeve osmane, me angazhimin e këtij komiteti u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në të cilin morën pjesë edhe iniciatorët këtij komiteti. (Isa Bicaj)

KOMITETI MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS (KMKK) (1918-1924). Organizatë politike dhe ushtarake, që kishte për qëllim çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. U themelua më 1 maj 1918 në Shkodër. Programi i miratuar në kuvendin themelues përbëhej nga tri pika ose nyja, në të cilat në mënyrë të përmbledhur pasqyroheshin drejtimit kryesore të veprimtarisë së organizatës. Në pikën e parë të programit thuhet se organizata (Komiteti i Kosovës, siç quhej shkurt) ka për qëllim kryesor “me u përpjekë para fuqive të mëdha të Antantës dhe me e kërkuar bashkimin e krahinave të Kosovës (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizaj, Gilan, Prishtinë, Vuçiternë, Mitrovicë, Jeni Pazar, Rozhajë, Pejë, Plavë, Guci, Gjakovë, Prizren) në një Shqipëri të lirë dhe veturdhënuese”. Edhe pse mbante emrin Komiteti i Kosovës, në pikën kryesore të programit organizata nuk e kishte synim çlirimin vetëm të territoreve të Kosovës së ngushtë, por angazhohej për çlirimin e të gjithë territoreve me popullsi shqiptare të pushtuara nga serbo-malazetët. Në një pikë tjetër të programit kundërshtoi fuqishëm politika antishqiptare, të cilën qeveria serbe e ndiqte ndaj popullit shqiptar.

Këshillin Qendror të KMKK-së e përbënin 7 anëtarë. Kryetar ishte Kadri Prishtina, sekretar Bedri Pejani, kurse nënkryetar Hysni Curri. Në kuadër të KMKK-së vepronin patriotë të shquar si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Aqif Elbasani, Azem Bejta, Sadik Rama, Ramadan Shabani, Ibrahim Gjakova, Qazim Bakalli, Beqir Vokshi, Niman Ferizi, Murat Gjakova, Bajram Daklani, Zefi i Vogël, Tafil Boletini, Ragip Kajabegolli, Qazim Kajabegolli etj. Përveç qytetit të Shkodrës, që ishte edhe selia e tij, Komiteti i Kosovës i kishte ngritur organizatat e tij edhe në Tiranë, Durrës, Elbasan, Dibër etj. Përmes degëve në Kosovë, posaçërisht të asaj që vepronte në Gjakovë, Komiteti e kishte shtrirë veprimtarinë edhe në Prizren, Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Shkup, Pejë, Podrimë, Rahovec, Vushtrri dhe në shumë qytete e fshatra të Kosovës dhe të viseve të tjera. Në territoret e okupuara shqiptare nga Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene aktiviteti zhvillohej ilegalisht.

Përveç çlirimit të Kosovës, Komiteti angazhohej edhe për stabilizimin e gjendjes në Shqipëri, duke ndjekur parimin se Shqipëria dhe çështja shqiptare ishte një dhe e pandarë dhe se problemi i Kosovës mund të zgjidhej vetëm nga një Shqipëri me qeveri patriotike dhe kombëtare. Komiteti i Kosovës disa herë iu drejtua kryetarëve të qeverive e ministrave të jashtëm të Fuqive të Mëdha, si dhe personaliteteve të tjera të larta botërore, me letra e me nota proteste për gjendjen në Shqipëri e posaçërisht në territorin e Kosovës. Qëllimi ishte sensibilizimi i çështjes shqiptare në arenën ndërkombëtare. Përveç këtyre dy detyrave kryesore KMKK-ja i kushtoi rëndësi të madhe stabilizimit të gjendjes brenda shtetit shqiptar. Organ i tij ishte gazeta “Populli”, që udhëhiqej nga patrioti Sali Nivica. KMKK-ja dha kontribut të çmuar në përpjekjet për përgatitjet dhe mbajtjen e Kongresit të Lushnjës. Gjatë ngjarjeve të qershorit 1924, KMKK-ja u vu në përkrahje të forcave dhe qeverisë së Fan Nolit, iu kundërvu ndërhyrjes së Ahmet Zogut në dhjetor të vitit 1924 dhe kundërshtoi rikthimin e tij në Shqipëri. Ndërkohë, divergjencat ndërmjet grupeve politike në Shqipëri në atë periudhë u thelluan aq shumë, sa që u pamundësua puna e mëtejshme e kësaj organizate. (Lush Culaj)

KOMITETI NACIONAL I SHQIPTARËVE (1945-1952). Organizatë e shqiptarëve të

Kosovës, pjesë e Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar. Komiteti Nacional i Shqiptarëve (KNSH) u themelua si kundërpeshë e Komitetit Nacional Demokratik të Shqiptarëve. Konferenca themeluese u mbajt në Prishtinë më 27-28 mars 1945 dhe në të morën pjesë afro 400 delegatë dhe mysafirë nga të gjitha viset e Kosovës. Konferencën e përshëndetën përfaqësuesit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, këshillave nacionalçlirimtare dhe të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. KNSH-ja angazhohej për të drejtat nacionale, ekonomike, politike, kulturore, arsimore dhe për emancipim të përgjithshëm të shqiptarëve në Kosovë. Konferenca zgjodhi plenumin e KNSH-së prej 100 anëtarësh dhe sekretariatit prej 10 anëtarësh në përbërje: Fadil Hoxha (kryetar), Rifat Berisha (nënkryetar i parë), Hasan Kryeziu (nënkryetar i dytë), Xhavit Nimani (sekretar) dhe anëtarë: Mehmet Hoxha, Kolë Shiroka, Rexhep Butovci, Mumin Jakupi, Nexhip Beqa dhe Pajazit Hamiti. Konferenca zgjodhi edhe një delegacion prej 20 vetash, i cili më 4 prill 1945 u prit në Beograd nga mareshali Tito. Në delegacion nuk u zgjodh as kryetari F. Hoxha dhe as sekretari Xh. Nimani. KNSH-ja kishte statusin e organizatës politike të masave, në kuadër të Frontit të Përbashkët Nacionalçlirimtar të Kosovës. Nga Konferenca themeluese e KNSH-së, deri në fillim të majit u mbajtën konferencat e rretheve të KNSH-së, të cilat zgjodhën komitetet e rretheve e sekretariatet dhe më pas formuan organizatat themelore në qytete dhe fshatra. Nga viti 1950 filloi të zhvillohej nga roli dhe funksionet, derisa më 1953 u shkri në Lidhjen Socialiste të Popullit Punues të Kosovës. (Fehmi Rexhepi)

KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK).

U themelua zyrtarisht në vitin 1992 në Prishtinë. Pas pranimit të KOK-ut në Komitetin Ndërkombëtar Olimpik (CIO), që u bë më 9 dhjetor të vitit 2014 sportistët e Kosovës marrin pjesë në të gjitha garat ndërkombëtare ballkanike, europiane dhe botërore, përfshirë edhe Lojërat Olimpikë. Komiteti Olimpik i Kosovës bashkëpunon me të gjitha strukturat e sportit të Kosovës, përcjell përparimin e të gjitha sporteve olimpikë, propagandon në vazhdimësi dhe zhvillon idenë e olimpizmit. KOK-u vendos për paraqitjen e sportistëve dhe të drejtuesve të sportit të Kosovës në Lojërat Olimpikë. Kosova mori pjesë në Lojërat

Europiane “Baku 2015” dhe në Olimpiadën Verore “Rio 2016” në Brazil. Xhivistja Majlinda Kelmendi ishte sportistja e parë që fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 52 kilogramë. (Xhavit Kajtazi)

KOMNENA Anna (rreth 1083-1150). Historiane bizantine dhe vajzë e perandorit Aleks Komneni I (1081-1118). Studioi letërsinë, filozofinë, historinë e gjeografinë dhe u pajis me arsimim të klasicizmit grek. U martua me historianin dhe gjeneralin Niqifor Brieni, të cilin u përpoq (së bashku me të ëmën, perandoreshën Irenë) ta shpallte perandor (1118). Dështimi ndikoi që së bashku me të ëmën të tërhiqen në manastir, duke iu përkushtua shkrimeve të historisë. Është e njohur me veprën e saj “Aleksiada” në 15 vëllime, në të cilën flitet për historinë e familjes Komneni (1069-1118). Vëzhgimet e saj janë të vlefshme për shkak të njohurive të gjera që kishte për sundimin e Aleks Komnenit I, si dhe për përdorimin e korrespondencës diplomatike, raportet e gjeneralëve të babait të saj me ushtarët, ndonëse ishte subjektive ndaj të atit, si dhe me gabime kronologjike të ngjarjeve. Megjithatë, vepra përbën informimin më burimor bizantin për Kryqëzatën I. Për historinë shqiptare të mesjetës u bë e njohur sidomos me njoftimin e etnonimit Arbër dhe emrit Arbanon në shek. XI-XII, si një krahinë e veçantë në po atë vend që e përmendte Ptolemeu fisin ilir me këtë emër. Në veprën e saj gjithashtu përmenden luftërat e Vukanit, zhuganit të Rashës në vitin 1093, ardhja e perandorit Aleksi I në Shkup dhe tërheqja e Vukanit në fortifikatën e Zveçanit, prej nga i kërkonte paqe perandorit bizantin. Nga vepra e saj u frymëzuan disa historianë e shkrimtarë të kohës së re. (Ramiz Abdyli)

KOMONI Sabahudin (1941-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme në Prishtinë, ndërsa studimet për ekonomi në Fakultetin Ekonomiko-Juridik të Universitetit të Prishtinës (1965). Gradën e magjistratit të shkencave ekonomike e mori në vitin 1972, ndërsa të doktorit në vitin 1979 në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkupit. Më 1967 filloi të punonte si asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe që atëherë, deri në vitin 2007, përveç

"Albi Commerce", "Albi Shopping", "Albi Mall", "Sportina&Albi", "Albi&Fashion" dhe "Sunday's". Në fund të vitit 2006 në Prishtinë u hap qendra tregtare "Albi Mall". Qendrën e përbëjnë: hipermarketi, shumë dyqane të tekstilit, dyqane të kozmetikës, të teknikës së bardhë, bizhuteri, barnatore, këndi i ushqimit me restorante dhe kafene, këndi i lojërave për fëmijë si dhe qendra për lojë boulingu. Në kuadër të "Albi Group", në zonën industriale Prishtinë-Fushë Kosovë është hapur qendra tregtare "Albi Outlet", e para e këtij lloji në Kosovë, e cila, përveç tjerash, ofron brende të ndryshme të tekstilit të sezonit paraprak. Në kuadër të Grupit, në Podujevë është hapur qendra tregtare "Albi Center", kurse në pika të ndryshme në Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Podujevë operojnë pesë hipermarkete dhe tetë supermarketete. Gjatë veprimtarisë afariste, nga 7 punëtorë sa kishte në themelimin e kompanisë, "Albi Group" ka arritur të rrisë numrin e të punësuarve në mbi 800 veta, duke kontribuar drejtpërdrejt në gjenerimin e vendeve të punës dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. (Fisnik Reçica)

KOMPANIA "BUÇAJ". Kompani ndër më të suksesshmet në Kosovë në fushën e shpërndarjes dhe shitjes së mallrave ushqimore, sanitare, të pijeve dhe të duhanit. Në bazë të organizimit të mirëfilltë, teknologjive të avancuara, orientimit kah blerësi, si dhe në bazë të kontributit të 210 punonjësve të kualifikuar, të cilët janë të punësuar në këtë korporatë, janë arritur suksese të qëndrueshme. Drejtpërdrejt bashkëpunon me 3,562 blerës, duke iu ofruar mbi 1,000 produkte të llojllojshme. Për dy vjet radhazi, korporata "Buçaj" renditet në vendin e parë si tatimpaguesi më i mirë i vitit dhe si korporata më e mirë në tregtimin e mallrave. Për përkrahjen e shitjes dhe përpunimit sa më të saktë dhe në kohë të të dhënave, korporata e ka të instaluar ERP-në, sistemin Navision, i cili është produkt i Microsoft-it dhe që mundëson raporte të ndryshme automatike mbi baza ditore si për korporatën, po ashtu edhe për prodhuesit. (Besnik Krasniqi).

KOMPANIA "DEVOLLI". E themeluar më 1989, është njëra ndër korporatat me zhvillim më të shpejtë në Kosovë. Filloi si një kompani e vogël me gjithsej 30 punëtorë e me teknologji të thjeshtë. Me vonë njohu një zhvillim shumë



KOMPANIA "DEVOLLI", PEJË

dinamik, duke u ndarë në "Devolli Company" dhe "Devolli Corporation", me një degëzim të portfolios së produkteve dhe të shërbimeve, nisur nga prodhimi i qumështit "Vita", "Princ kafe", prodhimi i miellit, operatorit "Z-mobile", terminali doganor, prodhimi i dyshekëve etj. Të dy këto organizata tani punësojnë rreth 2,200 punëtorë. Me ekipe të kualifikuara udhëheqësish e menaxherësh synon që në një periudhë afatmesme të rrisë numrin e punëtorëve. Me rrjetin gjithëpërfshirës të të dy degëve, kompania është e pranishme me prodhime dhe shërbime në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, duke zgjeruar eksportin edhe në shtete të tjera të rajonit. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA "DUKAGJINI". Njëra ndër ndërmarrjet e para private në Kosovë, e cila nisi aktivitetin që në vitin 1987, si ndërmarrje librare, botuese dhe tregtare. Kompania shumë shpejt u bë njëra nga bartëset më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në komunën e Pejës dhe më gjerë. Rritja e korporatës "Dukagjini" është e lidhur, para së gjithash, me shtypshkronjën, njësi punuese më vete, e cila bashkë me fabrikën e duhanit, kompaninë e sigurimeve, shtëpinë botuese, njësinë ndërtimore dhe rrjetin tregtar përbëjnë këtë korporatë tashmë të mirënjohur në mjedisin afarist të Kosovës. Korporata "Dukagjini" me 400 të punësuar paraqet një hallkë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA "ELKOS". Kompani ndër më të mëdhatë në Kosovë, që u themelua në vitin 1990, në fillim si një pikë e vogël tregtimi prej jo më shumë se 70 m². Që atëherë ka njohur një zhvillim shumë dinamik, duke hapur degët në qytete të ndryshme të Kosovës dhe



KOMPANIA "ELKOS", PEJË

në Mal të Zi. Që nga viti 2000, vëmendja e kësaj kompanie është drejtuar në krijimin e partneritetit me prodhues europianë për të drejtat e shpërndarjes dhe të shitjes së mallrave në Kosovë. Gjatë viteve 2001-2003 "ELKOS" përfundoi projektin "cash and carry" në qytetet më të mëdha të Kosovës. "ELKOS Center" është një qendër e re tregtare multidimensionale në kuadër të kompanisë "ELKOS Grup", e cila ofron një gamë të gjerë të prodhimeve inovative dhe shërbime cilësore, me çmime të arsyeshme për konsumatorin. Tani kompania ka të punësuar 2,700 punëtorë, me qarkullim mbi 300 milionë euro në vit dhe me veprimtari të degëzuar, krahas tregtisë, edhe në prodhimin dhe përpunimin e mishit, të plastikës, ambalazhimit të prodhimeve bujqësore si dhe qendrat e grumbullimit të tyre. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA "MABETEX". Pjesë e grupit "Mabetex", e themeluar në vitin 1990, me seli në Lugano të Zvicrës. Kompania është e specializuar në inxhiniering dhe projektme, veçmas në ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave të mëdha. Grupi "Mabetex" ka realizuar shumë projekte në Rusi dhe në ish-republikat e tjera sovjetike, sidomos në Kazakistan, por edhe në pjesët e tjera të botës. Jashtë Kosovës ka punësuar mbi 7,000 punëtorë dhe me shitje vjetore që tejkalojnë një miliard dollarë. Përfshin investime dhe angazhime biznesore në shumë sektorë dhe rajone të botës. Në Kosovë kjo kompani ka punësuar rreth 2,000 punëtorë dhe përfshin sektorin bankar (Bankën Ekonomike), hotelerinë (Hoteli "Swis Diamond"), sigurimet, ndërtimtarinë, tregtinë dhe prodhimin e qelqit. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA "M-SILLOSI". Prodhuesi dhe eksportuesi më i madh i miellit në Kosovë. Si pjesë e "Devolli Corporation" punëson mbi 90 punëtorë që angazhohen për përmbushje të nevojave unike të konsumatorëve dhe fermerëve. Me kapacitet ditor të prodhimit prej 600 tonelatash, sipas standardeve ndërkombëtare të ISO-s dhe HACCP-së, me kapacitet të sillosëve të grurit prej 58 mijë tonelatash, me laborator të vetëm të akredituar në Kosovë për analiza të miellit dhe të grurit dhe me shumë veçori të tjera, "M-Silloso" është njëra ndër fabrikat më avancuara të prodhimit të miellit në rajon. Prin në tregun kosovar me linjën e plotë të prodhimit të miellit dhe me shitjen e miellit me shumicë dhe pakicë. Përveç tregut të Kosovës, "M-Silloso" eksporton edhe në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA "STONE CASTLE". Kompani që përfshin vreshtarinë dhe prodhimin e verës, në kuadër të "Stone Castle Vineyards and Wnery L.L.C." në Rahovec. Është prodhuesi më i madh i verës në Kosovë dhe ndër më të mëdhenjtë në Ballkan. Filloi veprimtarinë prodhuese që nga viti 1953, fillimisht si ndërmarrje shoqërore, derisa u privatizua në gusht të vitit 2006. Kompania "Stone Castle" disponon 2,200 hektarë tokë bujqësore, nga të cilat 650 hektarë janë vreshta aktive. Kapacitetet rezervuese të prodhimit të verës janë 300,000 hl, nga të cilat 50,000 hl janë fuçi druri, për ruajtjen e verërave të cilësisë së lartë. Është eksportues i rëndësishëm i verërave në vendet fqinje dhe ato europiane. (Besnik Krasniqi)

KOMPANIA KEDS. Kompani për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike në Kosovë, e themeluar fillimisht në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). KEDS është privatizuar nga kompanitë "Çalik Holding dhe Limak" (2013). Kompania menaxhon të gjitha asetet për shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike deri te konsumatorët e fundit. Në kuadër të KEDS-it është rrjeti i shpërndarjes që përbëhet nga rrjeti i tensionit të mesëm 35 kV (625 km), 10(20) kV (1290 km), 10 kV (5,743 km), 6 kV (50 km) dhe rrjeti i tensionit të ulët 0.4 kV (11,665 km). Në rrjetin e shpërndarjes, në nivelet 35/10 kV, 35/10/6 kV dhe 35/10 kv janë 69 nënstacione, ndërsa në nivelet 35/0.4 kV, 10(20)/0.4 kV, 10/0.4 kV dh 6/0.4 kV janë 7,677 nënstacione, si dhe



SELIA E KOMPANISË KEDS

470,000 njehsorë, matës të konsumit individual të të gjitha kategorive të konsumatorëve. Me qëllim të hapjes dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike është bërë ndarja e aktiviteteve të shpërndarjes nga aktivitetet e furnizimit. Kështu, Kompania KEDS është ndarë në dy kompani me emrat: KEDS-i dhe KESCO-ja (2015). KEDS-i ka vazhduar t'i kryejë aktivitetet e shpërndarjes së energjisë, ndërsa Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh. a. (KESCO-ja), kryen aktivitetet e furnizimit. Aktivitetet e këtyre kompanive i nënshtrohen licencimit dhe rregullimit ekonomik nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, duke përcaktuar të hyrat e lejuara maksimale dhe tarifën e energjisë elektrike për konsumatorët. KESCO-ja ka më shumë se 470,000 konsumatorë të ndarë në tri kategori: familjarë, komercialë dhe industrialë; ka shtatë qendra për përkujdesje ndaj konsumatorëve, si dhe arkat për pagesë të energjisë elektrike në të gjitha komunat e Kosovës. (Justina Shiroka-Pula)

KOMPANIA. Një shoqëri afariste që ushtron aktivitet afarist. Përdoret si term për të përshkruar një shoqëri që kryen aktivitet tregtar, afarist, ekonomik apo industrial, e cila mund të jetë e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare. Më rrallë termi mund të përdoret për të përshkruar një partneritet të përgjithshëm apo partneritet të kufizuar, të cilët, ndonëse nuk kanë personalitete të veçanta juridike, kanë zotësinë për të kontraktuar dhe për të mbajtur në pronësi pasuri, të paditën dhe të padisin. Sipas ligjit në fuqi, në Kosovë kompania përdoret vetëm për korporatat, përkatësisht shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. (Dastid Pallaska)

KOMPLEKSI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT. Kompleks muzeor që prezanton eksponate nga periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si organizatë e parë politike



SHTËPIA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

dhe ushtarake me karakter mbarëkombëtar. Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ndodhet në qendër të Prizrenit, në lagjen e Gazi Mehmet pashës. Themelet dhe muret e katit përdhës janë prej gurësh, ndërsa katet e epërme janë prej druri të mbushur me qerpiçë. Çatia është e mbuluar me tjegulla të lugëta. Kompleksi përbëhet nga 3 objekte: nga Mësonjëtorja-Dersëhania (Sot Muzeu Historik i Lidhjes), Medreseja e Gazi Mehmet pashës (sot Sektori Etnologjik & Galeria e Arteve) dhe Biblioteka e Gazi Mehmet pashës (Sot Biblioteka e Lidhjes). Mësonjëtorja-Dersëhane u rrënuar në vitin 1968 dhe u ndërtua i dislokuar në vendin ku ndodhet tani. Ajo u rivalorizua në Muzeun Historik të Lidhjes me rastin e shënimit të 90-vjetorit të themelimit të saj. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, më 27 mars 1999, ajo u dogj, kurse u rindërtua në vitet 1999-2000. Muzeu Historik i Lidhjes përbëhet nga eksponatet, fotografitë dhe dokumentet më të rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit: kopja e Vendimit të Lidhjes e datës 18.6.1878, letërkëmbimet mes udhëheqësve të Lidhjes dhe personaliteteve politike të shteteve të jashtme, harta e territoreve shqiptare në vitet 1877-1881, shpata dhe ora e murit e familjes së Ymer Prizrenit, armë të kohës së Lidhjes, fotografi të personaliteteve të Lidhjes etj. Medreseja dhe Biblioteka e Gazi Mehmet pashës u restauruan në vitin 1978, me rastin e shënimit të 100-vjetorit të themelimit të Lidhjes. Medreseja, e cila është ndërtesë dykatëshe, u

rivalorizua në sektorin etnologjik dhe galeri të arteve. Sektori etnologjik ka eksponate të veshjeve kombëtare, të zejeve dhe artizanaleve nga hapësira mbarëshqiptare. Galeria e arteve prezenton skulptura, piktura, fotografi dhe tapiceri me tematikë të Lidhjes të autorëve nga Kosova dhe Shqipëria. Biblioteka e Gazi Mehmet pashës (sot Biblioteka e Lidhjes) ka libra, gazeta dhe revista me tematikë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kompleksi Monumental i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është muze i një rëndësie të veçantë, me vlera të mëdha historike, arkitektonike dhe kulturore. Sot ai është muzeu më i vizituar në Kosovë. (Shpresa Siqeca)

KOMPLEKSI I LIDHJES SHQIPTARE TË PEJËS (1899). Komplex ndërtimor afër Çarshisë së Vjetër të Pejës. Nga vendorët njihet si Konaku i Jashar Pashës, por, në të vërtetë,



KULLA KU U MBAJT KUVENDI I LIDHJES SHQIPTARE TË PEJËS

donator i tij ishte Haxhi Zeka. Komplexin e përbëjnë kulla trekatëshe, që njëherësh është oda e mysafirëve dhe shtëpia e grave, me objektet ndihmëse ekonomike dhe familjare. Në kullë është mbajtur kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Pejës në vitin 1899. Prandaj, pos vlerave ndërtimore dhe arkitektuale, godina ka edhe rëndësi historike. Ndërtimi është një realizim i standardeve të kohës, pasqyrë e rrethanave shoqërore-ekonomike dhe e gjendjes sociale të shfrytëzuesve, të cilët i takonin klasës së lartë të shoqërisë kosovare në fund të shek. XIX, në kuadër të Perandorisë Osmane. Bëhet fjalë për një objekt të arkitekturës popullore, të tipit të shtëpive të vjetra qytetare të Pejës, përkatësisht të ndërtimit karakteristik kosovar. Në aspektin tipologjik objektet e banimit të kompleksit, etazhet, struktura e murimit, teknika

e ndërtimit dhe elementet konstruktive dhe funksionale ndryshojnë nga njëra-tjetra. Oda e mysafirëve është trekatëshe dhe i takon tipit kullë, kurse shtëpia e grave ose e zjarrit është dykatëshe dhe i takon banesës me çikma ose ballkone të mbyllur. Karakteristikë për këtë lloj ndërtimi është fakti se dhomat e gjumit kanë pasur hamamxhik. Kompleksi kishte oborrin me lulishte, përroskën dhe rruginat të shtruara me kalldrëm. Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1999) kompleksi u dogj. Së fundi është bërë restaurimi, por kanë humbur elementet e pasura dekorative të enterierit. (Fejaz Drançolli)

KOMUNAT E KOSOVËS. Njësi themelore territoriale-administrative në Republikën e Kosovës. Pas luftës së fundit e këndej Republika e Kosovës ka sistem dyshkallësh: pushtetin qendror dhe pushtetin lokal. Pushteti qendror ushtrohet në tërë hapësirën shtetërore, ndërsa pushteti lokal ushtrohet brenda territorit të komunës përkatëse. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 12) komunat përcaktohen "si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës". Komunat ushtrojnë tërë pushtetin, i cili shprehimisht nuk është rezervuar për pushtetin qendror. Komunat rregullojnë dhe udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë, për të gjithë banorët e Kosovës. Komunat e kanë territorin e kufizuar, i cili mund të ndryshohet vetëm nga pushteti qendror, pas konsultimeve paraprake me komunat përkatëse. Republika e Kosovës i ka 38 komuna. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina, i cili nuk ka ligj të veçantë, por ka statutin, njësoj si komunat e tjera. Në përputhje me Planin e Ahtisarit u krijuan edhe komunat e reja: komuna e Mamushës, Graçanicës, Mitrovicës së Veriut, Ranillugut dhe Parteshit. Autorizimet kryesore publike të komunave janë: planifikimi urban dhe i fshatit, shfrytëzimi i tokës, lëshimi i lejeve për ndërtim, mbrojtja lokale e ambientit, zbatimi i rregullave të ndërtimit dhe kontrollimi i standardeve të ndërtimit, ofrimi i shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës, duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rrugët lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale, edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, kujdesin shëndetësor, shërbimet sociale, mbrojtjen e konsumatorëve

etj. Komunat kanë organet e veta qeverisëse: kuvendin e komunës, kryetarin dhe nënkryetarin, kryeshefin ekzekutiv dhe bordin e drejtorëve. Kuvendi i komunës është organi më i lartë i komunës, i cili zgjidhet drejtpërdrejt në zgjedhjet lokale. Kryetari i komunës mbikëqyr administrimin financiar të komunës dhe ekzekutimin e vendimeve të miratuara në kuvendin komunal. Kryeshefi ekzekutiv dhe bordi i drejtorëve përbëjnë ekzekutivin e komunës. Kryeshefi zgjidhet nga kuvendi i komunës me propozimin e kryetarit të komunës, ai ushtron punët e sekretarit të komunës, është kryesues i bordit të drejtorëve, është përgjegjës për udhëheqjen efikase të çështjeve financiare të komunës, për mbajtjen dhe zhvillimin e procedurave dhe kontrollimeve efektive financiare etj. Të gjithë kryetarët e komunave janë pjesë e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës. (Osman Ismaili)

KOMUNIKACIONI AJROR. Është i përqendruar kryesisht në Aeroportin e Prishtinës. Ndërtimi i Aeroportit të Prishtinës në vitin 1964 bëri që Kosova ta plotësojë nevojën dhe të përparojë në kompletimin e sistemit të komunikacionit. Në vitin 1968 aeroporti modernizohet dhe përfshihet në komunikacionin e ish-Jugosllavisë dhe atë ndërkombëtar përmes lidhjes Prishtinë-Beograd. Në vitin 1985 u pajis me teknologji moderne, kështu që me 1988 në Aeroportin e Prishtinës punonin 50 punëtorë, duke u shërbyer rreth 6,000 udhëtarëve në vit. Pas luftës, që më 1999, Aeroporti i Prishtinës është bërë aeroport ndërkombëtar, me operim të fluturimeve humanitare nën përkujdesjen e KFOR-it. Renovimet e bëra në vitin 2002 e kanë rritur kapacitetin dhe shërbimet e Aeroportit, të cilat arritën nga 800,000 deri në 1,000,000 udhëtarë në vitin 2005. (Ramiz Livoreka)

KOMUNIKACIONI HEKURUDHOR. Kosova ka një mbulim relativisht të mirë me rrjet hekurudhor dhe përdorimi i tij ishte mjaft i madh deri në fund të viteve '90. Në vitin 1988 Hekurudhat e Kosovës i kishte gjithsej 60 stacione hekurudhore dhe 3,204 punëtorë. Pas luftës së vitit 1999 Hekurudha e Kosovës ofron shërbimet të transportit të mallrave konvencionale me vagonë klasikë dhe të kombinuar vagonë/kamionë. Po ashtu e organizon transportin e mallrave me kontejnerë nga të gjitha vendet, kryesisht përmes portit

të Selanikut, deri në terminalin "Miradia" në Fushë Kosovë. Transportin e udhëtarëve e organizon brenda dhe jashtë Kosovës, në linjat: Prishtinë-Pejë-Prishtinë (çdo ditë me tren të shpejtë dhe tren lokal), Fushë Kosovë-Hani Elezit-Fushë Kosovë (çdo ditë me tren lokal) dhe Prishtinë-Shkup-Prishtinë (një herë në ditë me tren të shpejtë). Hekurudhat e Kosovës këto shërbime i kryejnë me rrjetin ekzistues të rrugëve, me 8 lokomotiva dizel, me 27 vagonë (9 të udhëtarëve dhe 18 të bagazhit). Gjatë kësaj periudhe transporti i udhëtarëve dhe i mallrave ka shënuar rritje graduale: nga 317 mijë udhëtarë në vitin 2005, arriti në 417 mijë në vitin 2007; nga 298 mijë tonë mallra në vitin 2005 arriti në 1,129 mijë tonë në vitin 2010 (Ramiz Livoreka)

KOMUNIKACIONI RRUGOR. Sasia dhe cilësia e komunikacionit rrugor është e kushëtuar me zhvillimin e rrugëve, me sasinë dhe cilësinë e mjeteve që përdoren. Në vitin 1957 Kosova kishte vetëm 31 km rrugë moderne, ndërsa në vitin 1988 rrugët transportuese të Kosovës kapnin gjatësinë 1, 950 km. Për këtë periudhë, kjo rritje e sasisë së rrugëve ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve transportuese: të automobilave për udhëtarë për 250.5 herë, të autobusëve për 17.3 herë, të automjeteve transportues për 18.2 herë dhe të automjeteve tërheqëse për 102.8 herë. Rritja kishte për rrjedhojë edhe rritjen e numrit të udhëtarëve: nga 425 mijë në vitin 1957 në 57,470,000 në vitin 1988, të mallrave nga 49,000 tonë në vitin 1957 në 1,350,000 tonë në vitin 1988. Gjendja e rrugëve në Kosovë pas luftës së vitit 1999 ishte e keqe dhe riparimi i tyre ishte emergjent. Në këtë periudhë një numër rrugësh u meremetuan dhe u asfaltuan me ndihmën e KFOR-it, të Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë. Në vitin 2005 Kosova kishte gjithsej 1,925.1 km rrugë, prej të cilave 630.4 km rrugë nacionale dhe 1,294.7 km rrugë rajonale. Prej vitit 2007 ka filluar një proces investimi në rrugët e vendit dhe prej vitit 2009 gjatësia e rrugëve të asfaltuara është rritur vazhdimisht dhe në vitin 2014, krahasuar me vitin 2005, kemi rritje për 13% të rrugëve të asfaltuara. Në vitin 2013 këtyre rrugëve u është shtuar edhe autostrada në gjatësi 78 km e "Rrugës së Kombit", të cilës do t'i shtohet edhe autostrada Prishtinë-Shkup me gjatësi 60 km, që është në ndërtim e sipër

nga muaji gusht i vitit 2014. Në ndërtim e sipër janë edhe rrugët moderne Prishtinë-Pejë dhe Prishtinë-Mitrovicë. Prej vitit 2012 deri 2015 në Kosovë janë asfaltuar 138.64 km rrugë, janë rehabilituar 135.26 km (prej tyre rrugë lokale 111.46 km, rajonale 13.5 km dhe nacionale 10.3 km); janë ndërtuar 187.61 km (prej tyre 154.52 km rrugë lokale, 16.09 rrugë rajonale dhe 17.0 rrugë nacionale); janë rikonstruktuar 68.28 km rrugë lokale dhe rrugë të zgjeruara 48.05 km (prej tyre 32.14 rrugë lokale dhe 15.91 rrugë nacionale). Edhe numri i mjeteve të transportit ka ndryshuar përgjatë viteve, duke shënuar rritje për të gjitha kategoritë. Kështu, në vitin 2014, në krahasim me vitin 2011, veturat janë rritur për 38.6%, automjetet e transportit prej 3.5 tona dhe mbi janë rritur për 45%, automjetet e transportit nën 3.5 janë rritur për 50.5%, autobusët kanë shënuar rritje për 51.9% etj. (Ramiz Livoreka)

KOMUNITETI HEBRAIK NË KOSOVË.

Hebrenjtë e Kosovës i përkasin komunitetit sefardik, të cilët ishin dëbuar nga Spanja dhe Portugalia në shek. XV. Komuniteti hebraik në Kosovë përbëhej nga tregtarë, zejtarë dhe mjekë. Ata mësuan gjuhët shqipe, turke dhe serbe. Sinagogat e tyre i mbijetuan periudhës osmane, por u shkatërruan nga regjimi komunist. Prishtina dikur kishte pazarin më të famshëm hebraik në tërë rajonin. Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë janë strehuar rreth 500 familje hebreje. Aktualisht në Kosovë jetojnë vetëm 56 prej tyre. Qendra e komunitetit hebraik në Kosovë ka qenë në Prishtinë, ku janë vendosur që nga viti 1863 (familjet Bivas, Navon, Kalderon, Mandil, Koen etj.). Në shekullin XIX Prishtina ishte e njohur për zeje të ndryshme, si: argjendari, rrobaqepësi etj., ku hebrenjtë ishin të përfshirë në veprimtari të tilla. Pas Luftës së Dytë Botërore (1948) shumica e familjeve hebraike emigruan në Izrael. Në një letër përshëndetjeje që bëri Komiteti i Hebrenjve të Jugosllavisë, shkruhej: “Në historinë e kësaj lufte botërore do të mbetet i shënuar një popull i vogël, por bujar dhe heroik, populli shqiptar, i cili do të shënohet si i vetmi ndër popujt e okupuar të Europës që pengoi dhe ndaloi shfarosjen dhe ndjekjen e hebrenjve”. (Qemajl Morina)

KONCERTET PËR SOLIST DHE ORKESTËR.

Vepra ciklike, në tri e më rrallë në katër

kohë kontrastive, rëndom për një instrument solist dhe orkestër, por në raste edhe për dy, më rrallë për tre instrumente, solistë dhe orkestër. Solisti ka rol primar, me qëllim që të dalë në pah teknika, virtuozyteti, muzikaliteti dhe pastërtia tingullore, si dhe aftësitë e tjera. Orkestra te koncerti për solist e orkestër ka rol shoqërues, mbështetës për solistin. Në periudhën barokiane, para klasicistëve vjenezë, koncerti për solistë e orkestër kishte rëndom katër kohë. Një tip me kërkesa tekniko-artistike më modeste, me kohë më të shkurtra, madje vetëm me një kohë quhet koncertino (koncert i vogël). Koncerte janë kompozuar gati për secilin instrument që bën pjesë në orkestër. Sa i përket frymorëve të drunjtë, dominojnë koncertet për flaut, klarinet, më pak për obo apo fagot. Sa i përket frymorëve të tunxhtë, dominojnë koncertet për trumbetë dhe bri (kornë), më pak për trombon a tubë. Te harqet dominojnë koncertet për violinë, violonçel e më pak për violë apo kontrabas. Kështu, shumë koncerte që janë kompozuar për piano, më parë janë kompozuar për (klavi) çembal e orkestër. Koncerte për instrument solistik e orkestër ndër ne kanë kompozuar: T. Daija, Ç. Zadeja, T. Harapi, N. Zoraqi, P. Gaci, F. Ibrahim, E. Rizvanolli, A. Koci, Z. Ballata, K. Laro, R. Rudi dhe të tjerë më të rinj. (Zeqirja Ballata)

KONCESIONI. Dhënia e të drejtave dhe privilegjeve të caktuara nga qeveria për një subjekt të së drejtës. Sipas ligjeve në Kosovë, koncesioni mund të përfshijë dhënien e të drejtës për të ushtruar një aktivitet të caktuar në kompetencë shtetërore nga një subjekt i të drejtës brenda një juridiksioni, të cilat i nënshtrohen kushteve ligjore ose donjë kontrate të caktuara. Koncesioni mund të përdoret për të nënkuptuar lëshimin pe gjatë adresimit të një situatë, për të arritur një marrëveshje të caktuar. (Dastid Pallaska)

KONÇULI. Vendbanim rural, 10 kilometra në perëndim të Bujanocit. Shtrihet në brigjet e Moravës së Binçës në grykën e Konçulit, në lartësi mbidetare 420-460 m. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 1,384 ha dhe në aspektin fizionomik ndahet në dy tërësi, në anën e majtë përtej rrugë dhe në anën e djathtë, matanë Moravës. Të dy anët e fshatit i lidh ura e ndërtuar në vitin 1967. Konçuli në vitin

1961 kishte 1,185 banorë, ndërsa në vitin 2002 kishte 1,761 banorë rezidentë. Prej objekteve të standardit shoqëror ka shkollën tetëvjeçare dhe stacionin shëndetësor. Afërsia gjeografike e Konçulit me fshatrat e Ananmoravës ka bërë që lidhjet familjare dhe fafësnore të jenë më të shpeshta me këto fshatra se me ato të komunës së Bujanocit dhe të Luginës së Preshevës. (Arsim Ejupi)

KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR (1912-1913). Konferencë e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, për të zgjidhur problemet që dolën pas humbjes së Perandorisë



KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR (1912-1913)

Osmane në luftë kundër aleatëve ballkanikë. Konferenca i filloi punimet më 17 dhjetor 1912 dhe në të morën pjesë: Britania e Madhe, Gjermania, Rusia, Franca, Austro-Hungaria dhe Italia. Prej të gjitha këtyre shteteve vetëm Britania përfaqësohej nga shefi i diplomacisë Sir Eduard Grey. Të tjerët përfaqësoheshin në nivel ambasadorësh: Austro-Hungaria përfaqësohej nga ambasadori Mensdorf, Gjermania nga ambasadori Lihnovski, Rusia nga ambasadori Benkendorf, Franca nga ambasadori Kambon dhe Italia nga ambasadori Imperial. Palët e përfshira në konflikt kishin të drejtë të paraqitnin mendimet e tyre, por jo të merrnin pjesë në vendimmarrje. Në këtë grup bënte pjesë edhe Shqipëria. Në kushtet në të cilat u mblodh dhe problemet që shqyrtoi, doli e qartë se kjo konferencë kishte për qëllim zgjidhjen e kontradiktave të fuqive të mëdha rreth Shqipërisë dhe Ballkanit. Në mbledhjen e parë Konferenca vendosi që Shqipëria të jetë “shtet autonom”, nën sovranitetin ose suzeranitetin e sulltanit. Më 29 korrik 1913 u mor vendimi që Shqipëria të njihet “principatë

e pavarur”, duke përjashtuar çfarëdo lidhje vartësie me Perandorinë Osmane. Konferenca nuk e njohu qeverinë e përkohshme të Ismail Qemalit, por vendosi që kjo çështje të mbetet kompetencë e Fuqive të Mëdha. Në përfundim të konferencës u vendos që të përjashtohej çdo lidhje suzeraniteti midis Shqipërisë dhe Turqisë; që Shqipëria të shpallej shtet asnjans dhe që garantohej nga të gjashtë fuqitë e mëdha; që kontrolli mbi shtetin shqiptar do të ushtrohej nga Komiteti Ndërkombëtar i Kontrollit i përbërë nga delegatë të 6 fuqive dhe një delegat shqiptar; që kompetencat e këtij komisioni do të vazhdonin 10 vjet dhe në rast nevojë mund të zgjateshin; që ky komision do ta ngarkohej të përpunonte një projekt organizimi të hollësishëm për të gjitha degët e administratës së Shqipërisë. Komisioni kishte për detyrë që në një afat prej 6 muajsh t’u paraqiste Fuqive të Mëdha një raport mbi rezultatit e punës së tij, si dhe përfundimet e tij në lidhje me organizimin administrativ dhe financiar të vendit, ndërkaq një princ do të emërohej që ta qeveriste Shqipërinë në një afat prej 6 muajsh. Funksionimi i autoriteteve ekzistuese të vendit si dhe i xhandarmërisë do të kontrollohej nga Komisioni Ndërkombëtar, ndërsa rendi publik do të sigurohej nga organizata ndërkombëtare e xhandarmërisë. U vendos që oficerët e huaj të kenë komandën eprore dhe efektive të xhandarmërisë dhe se ata do të merreshin nga ushtria suedeze. Sa i takon kufijve dhe territorit që do të përfshinte shteti shqiptar, Konferenca i cenoi rëndë interesat e popullit shqiptar. Brenda kufijve të shtetit u përfshin vetëm gjysma e territoreve, me një sipërfaqe prej 28 mijë km katrorë dhe më pak se gjysma e popullsisë shqiptare, rreth 800 mijë banorë. Më tepër se gjysma e popullit shqiptar mbetën nën Serbi, Mal të Zi dhe Greqi. (Frashër Demaj)

KONFERENCA E BUJANIT (1943/44). Mbledhje themeluese e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit. Vendimin për formimin e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar e mori Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste të Jugosllvisë për Kosovë dhe Metohi (Dukagjin) në Këshillimin e Sharrit (4-6 nëntor 1943), ku merrnin pjesë edhe anëtarët e Shtabit Kryesor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) për Kosovë dhe Metohi (Dukagjin) dhe përfaqësuesit e komiteteve të vendit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Konferenca



KULLA KU U MBAJT KONFERENCA E BUJANIT

u mbajt në kullën e Sali Manit, në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës nga data 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944. Në këtë kohë në zonën e lirë të Malësisë së Gjakovës vepronin batalionet partizane “Bajram Curri”, “Perlat Rexhepi” dhe “Rinia”, njëherësh aty gjendej Shtabi Kryesor i UNÇ për Kosovë dhe Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë. Prej 61 delegatëve sa duhej të vinin në bazë të ftesës së Shtabit Kryesor të UNÇ dhe aradheve partizane të Kosovës, në Bujan morën pjesë 49 sish. Edhe pse nuk morën pjesë në punën e konferencës, u vendos që të trajtohen si anëtarë të Këshillit edhe dy delegatë: Ali Shukriu dhe Milan Zeçari, të cilët dërguan letra, me anë të të cilave informonin se nuk mundur të vinin në Bujan për shkak se gjendeshin në pozita luftarake, por pajtoheshin me vendimet që do të merrreshin në atë konferencëkonferencë. Pra, 12 delegatë nuk arritën të shkonin në Bujan për shkak të rrethanave të luftës. Prej gjithsej 51 delegatëve, 43 ishin shqiptarë, 4 serbë, 3 malazias dhe 1 mysliman. Përgatitjet për mbajtjen e Konferencës i bëri KK i PKJ-së për Kosovë në krye me Pavle Joviqeviqin. Shumica e delegatëve ishin komunistë, por nuk mungonin nacionalistët, atdhetarët demokratë, përfaqësuesit e njësive të armatosura, të rinisë dhe të gruas antifashiste, të këshillave nacionalçlirimtare etj. Përveç përfaqësuesve nga Kosova, në Bujan morën pjesë edhe delegatë nga Plava e Gucia, si dhe disa nga Malësia e Gjakovës, që administrativisht i takonte Shqipërisë.

Konferencën e shpalli të hapur Xhevdet Doda, delegat i Brigadës Kosovare-Maqedone më 31 dhjetor në orën 19. Përveç kryesisë së punës prej 7 anëtarësh dhe 2 procesmbajtësve, u zgjodh edhe këshilli verifikues prej 3 anëtarësh.

Konferencën e përshëndetën komandanti i Shtabit Kryesor të UNÇ-së dhe aradheve partizane për Kosovë, Fadil Hoxha, i cili foli për zhvillimet dhe sukseset e Luftën Nacionalçlirimtare (LNÇ) dhe të luftës së armatosur në këtë trevë; sekretari i KK të PKJ-së për Kosovë, Pavle Joviqeviq, që foli për rolin udhëheqës të PKJ-së në LNÇ; Xhafer Vokshi, përfaqësues i Komitetit Krahinor të Rinisë Komuniste foli për rolin e rinisë në LNÇ; Sabrije Vokshi, përfaqësuese e Frontit Antifashist të Grave të Kosovës foli për rolin e grave në LNÇ; delegati i Krasniqes, Mehmet Bajraktari, foli për qëndrimin patriotik dhe luftarak si traditë e kësaj treve; përfaqësuesi i Misionit Ushtarak Anglez në kuadër të Shtabit Kryesor (Major Brailly) theksoi se LNÇ-ja është e vetmja lëvizje në këtë vend që lufton kundër pushtuesit fashist, dhe në fund foli Xhevdet Doda, delegat i Brigadës Kosovare-Maqedone. Të nesërmen më 1 janar 1944 (në orën 8 e 30) filloi seanca e parë e rregullt e KKNÇ-së, ku referatin “Situata politike dhe formimi i Këshillit Nacionalçlirimtar” e mbajti Mehmet Hoxha. Pastaj Xhavit Nimani paraqiti referatin “Mbi Këshillat Nacionalçlirimtare”. Pas referateve dhe diskutimeve u zgjodh komisioni për hartimin e dokumenteve të Konferencës (Rezolutës dhe Thirrjes drejtuar popujve të Kosovës) ku bënë pjesë: Z. Rexha, H. Dushi, M. Hoxha, P. Joviqeviq, Xh. Hana, F. Hoxha, Xh. Nimani dhe M. Milkoviq. Konferenca zgjodhi edhe kryesinë prej 9 anëtarësh me këtë përbërje: M. Hoxha, kryetar; P. Joviqeviq, nënkryetar; R. Berisha, nënkryetar; dhe Xh. Doda, F. Hoxha, H. Dushi, Z. Rexha, M. Zeçar e A. Shukriu anëtarë.

Diskutime të ashpra u zhvilluan rreth tekstit të Rezolutës, e cila duhej të konfirmonte vullnetin politik të shqiptarëve të Kosovës për t’iu bashkëngjitur Shqipërisë. Meqë delegatët serbo-malazias që përbënin strukturën kryesore politike dhe ideologjike të PKJ-së nuk u pajtuan që dokumenti të shprehte kërkesën e popullit të Kosovës për bashkim me Shqipërinë, siç kërkonin disa delegatë shqiptarë. U arrit kompromisi që teksti i Rezolutës ta shprehte të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje deri në shkëputje si parim universal. Garant për zbatimin e këtij vendimi të ish-in Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, si dhe aleatët: Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Amerika (Karta e Atlantikut dhe e Teheranit).

Rezoluta gjithashtu shpallte qëllimin e Konferencës për vëllazërimin e popujve dhe për bashkimin e të gjithë patriotëve në luftë kundër pushtuesit fashist. Ajo në një mënyrë përcaktonte edhe zgjidhjen afatgjatë të problemit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës: vëllazërimi me popujt jugosllavë dhe lufta e përbashkët kundër okupatorit. Populli i Kosovës i priti me entuziazëm vendimet e Konferencës, ndërsa udhëheqja jugosllave i kundërshtoi ato. Kështu, më 28 mars 1944, Komiteti Qendror i PKJ-së, përmes një letre të nënshkruar nga Millovan Gjillasi sulmoi vendimet e Konferencës lidhur me të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje deri në shkëputje, pas fitores mbi fashizmin. Kontradiktat e brendshme në Konferencë, si dhe dualizmi i Rezolutës, ishin shkas që rëndësia dhe konteksti i kësaj ngjarjeje të interpretohej në mënyra të ndryshme, si nga politika ashtu edhe nga historiografia. Për këtë arsye edhe historiografia e Kosovës e periudhës së socializmit jugosllav bënte një interpretim të kujdesshëm të Konferencës së Bujanit. Më vonë, pas rënies së komunizmit, ndryshoi rrënjësisht edhe interpretimi i saj: nga disa historianë ajo konsiderohet herë si një pararendëse e largët e idesë së pavarësisë së Kosovës, herë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, kurse nga disa të tjerë si një farsë e komunistëve jugosllavë dhe shqiptarë. (Fehmi Rexhepi)

KONFERENCA E PAQES NË PARIS (1946). Konferencë e mbajtur në Paris në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, me shtetet fitimtare të luftës (SHBA, Bashkimi Sovjetik, Britania dhe Franca) dhe të shteteve të tjera të përfshira në këtë luftë. Konferenca mbahej për të negociuar detajet e traktateve pas përfundimit të luftës, ku çështje kryesore ishin reparacionet e luftës, të drejtat e pakicave dhe kufijtë. Konferenca u mbajt më 29 korrik-15 tetor 1946 dhe u kurorëzua me Traktatin e Paqes, që u nënshkrua në Paris më 10 shkurt 1947. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Shqipëria nuk u njoh si fuqi aleate. Kjo u bë vetëm në Konferencën e Paqes në Paris. Kështu Shqipëria u pranua si shtet jo i mundur, por juridikisht as fitues. Qeveria greke e shfrytëzoi mjaft këtë qëndrim hipotetik të ndërkombëtarëve. Megjithatë, në përfundim kjo konferencë vlerësoi kontributin e popullit shqiptar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe Shqipërisë ia njohu sovranitetin dhe

pavarësinë. Në këtë mënyrë ajo gëzoi të drejtën e reparacioneve, por kufijtë e Shqipërisë nuk u nënshtruan rivendikimit. Shtetet fqinje të Shqipërisë, Jugosllavia dhe Greqia, moshapjen e çështjes së kufijve me Shqipërinë në Konferencë, sikundër edhe të pakicave shqiptare në këto shtete, e konsideruan si mundësi për të ndërmarrë operacione spastrimi dhe të hakmarrjes mbi popullsinë e pambrojtur. (Izber Hoti)

KONFERENCA E PAQES NË VERSAJË (1919-1920). Konferencë ndërkombëtare e paqes, e organizuar nga Fuqitë e Mëdha prej 18 janarit 1919 deri më 21 janar 1920. Konferenca



PJESËMARRËSIT E KONFERENCËS SË PAQES NË VERSAJË (1919-1920)

kishte për qëllim t'i jepte fund gjendjes së luftës ndërmjet palëve të konfrontuara: Antantës, në njërën anë, dhe Bllokut Qendror, në anën tjetër. Konferenca që në fillim u kthye në arenë grindjesh ndërmjet vetë fuqive fituese, për shkak të ndarjes së plaçkës së luftës. Në ato rrethana, rreziku i copëtimit të Shqipërisë u bë më kërcënues se kurrë më parë. Edhe në aspektin ndërkombëtar Shqipëria ishte në pozitë të vështirë, ngase Austro-Hungaria, e cila e kishte ndihmuar çështjen shqiptare në Konferencan e Londrës, tani nuk kishte kurrfarë ndikimi.

Interesat e qytetarëve shqiptarë në Versajë do t'i përfaqësonin disa delegacione, por delegacioni kryesor ishte ai i Qeverisë së Durrësit në përbërje: Turhan pashë Permeti, kryetar, imzot Luigj Bumçi, Mehmet Konica, Luigj Gurakuqi, dr. Mihal Turtulli dhe Mustafa Kruja. Në këtë delegacion patër Gjergj Fishta merrte pjesë si ekspert. Kërkesat e Qeverisë së Durrësit kishin të bënin kryesisht me kthimin e pavarësisë së shtetit shqiptar, të cilën e kishte njohur dhe garantuar Konferenca e Londrës e vitit 1913 dhe

me kthimin e territoreve që i ishin dhënë Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë me Kongresin e Berlinit dhe Konferencën e Londrës. Delegacioni i Qeverisë së Durrësit kishte kërkuar gjithashtu mandatin e ndonjërës nga Fuqitë e Mëdha mbi territoret e aneksuara, deri në mbajtjen e një plebishiti.

Në Konferencën e Paqës u përgatitën dhe u nënshkruan pesë traktate paqeje: me Gjermaninë, me Austrinë, me Hungarinë, me Bullgarinë dhe me Turqinë. Konferenca nuk i përfilli kërkesat e drejta të delegacionit shqiptar për të ruajtur pavarësinë dhe tërësinë tokësore të shtetit shqiptar dhe për të rishikuar kufijtë në favor të tij, duke përfshirë brenda tyre ato territore shqiptare që ishin shkëputur më 1878 e 1913. Konferenca mori parasysh pretendimet ndaj Shqipërisë të tre shteteve fqinje fituese të luftës: Italisë, Greqisë e Jugosllavisë. Prej shkurtit 1919 e deri në mars 1920 në Konferencë u hartuan disa projekte për të ardhmen politike dhe territoriale të Shqipërisë, përfshirë edhe zhdukjen e saj nga harta politike e Europës si shtet i pavarur dhe sovran. Vlora dhe krahina e saj do të kalonin nën sovranitetin e Italisë, ndërsa shteti shqiptar do të vihej nën mandatin italian; Greqia do të merrte krahinën e Gjirokastrës, kurse e ardhmja e krahinës së Korçës mbetej ende në diskutim, nëse do t'i kalonte Greqisë apo do t'i mbetej Shqipërisë. Jugosllavia do të gëzonte të drejtën e një daljeje tregtare në detin Adriatik. Në janar të vitit 1920, në kuadër të zgjidhjes së çështjes së Adriatikut, u hartua edhe një projekt për t'ia kaluar Shkodrën Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, por ndeshën në kundërshtimin e SHBA-së.

Konferenca e Versajës e sanksionoi, nga pikëpamja ndërkombëtare, copëtimin e mëhershëm të trojeve shqiptare. Konferenca e Parisit 1919-1920 e ndryshoi hartën politike të Europës, të Azisë dhe të Afrikës. Shqipëria mbeti si shtet i ndarë, pa pjesët më vitale, pa Kosovën, Çamërinë dhe pjesë e tjera, sepse u morën për bazë argumentet politike, por të paktën u arrit që të rifitohej pavarësia e vendit dhe sidomos të mënjanohejshin padrejtësi të reja territoriale. (Lush Culaj)

KONFERENCA E PARISIT (15-19 mars 1999). Ishte raundi i dytë i bisedimeve pas Konferencës së Rambujesë, për nënshkrimin e “Marrëveshjes së përkohshme për paqe në



KONFERENCA E PARISIT (15-19 MARS 1999)

Kosovë”, që u zhvillua në Qendrën e Konferencave në Paris nga 15-19 mars 1999. Derisa delegacioni i Kosovës u deklarua i gatshëm ta nënshkruante marrëveshjen, delegacioni serb e refuzoi atë. Në letrat dërguar kryesuesit të Këshillit të Bashkimit Europian (BE), Joshua Fisher, dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së, Wolfgang Petritç, në emër të delegacionit të Kosovës, Hashim Thaçi, pohonte pranimin e marrëveshjes për Kosovën. Në të njëjtën ditë, kryesuesi i delegacionit serb, Ratko Marković, provoi të rihapte bisedimet nga e para, duke dorëzuar një version krejtësisht të ripunuar të marrëveshjes politike. Ndërkohë, më 17 mars Grupi i Kontaktit bëri përpjekjen e fundit për ta bindur delegacionin serb/jugosllav të ndryshonte qëndrim. Kur më 18 mars 1999 delegacioni i Kosovës nënshkroi Marrëveshjen, Konferenca u shpall e mbyllur. Dokumentin e nënshkruan edhe dy ndërmjetësit ndërkombëtarë, Wolfgang Petritç (BE) dhe Kristofer Hill (SHBA). Ndërkaq, delegacioni serb dhe ndërmjetësi rus, Boris Majorški, megjithëse ishin të pranishëm në ceremoni, refuzuan nënshkrimin e dokumentit.

Në të njëjtën ditë, më 18 mars, tre ndërmjetësit ndërkombëtarë i dërguan një letër të fundit kryesuesit të delegacionit serb/jugosllav, në të cilën shprehnin edhe një herë gatishmërinë për të filluar në çdo kohë bisedimet për pranimin e marrëveshjes së paqes për Kosovën. Por Millosheviqi edhe më tej e refuzoi kategorikisht Marrëveshjen e Rambujesë. Në të njëjtën kohë, kryesuesi i OSBE-së, Vollebek, njoftoi se bashkëpunëtorët e Misionit Verifikues të Kosovës do të tërhiqeshin menjëherë nga Kosova. Për ta evituar përsëritjen e një Bosnje të dytë, NATO-ja u vu në veprim. Më 24 mars 1999, NATO-ja

filloi fushatën ajrore kundër objektivave ushtarake dhe infrastrukturës represive të shtetit serb. Fushata ushtarake e NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur zgjati 78 ditë dhe përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, më 9 qershor 1999 midis gjeneralëve të NATO-s dhe ushtarakëve të Beogradit. Sipas kësaj Marrëveshjeje, nga Kosova u larguan të gjitha trupat ushtarake dhe policore, si dhe e gjithë administrata e dhunshme serbe. (Sylë Ukshini)

KONFERENCA E RAMBUJESË (shkurtmars 1999). Konferencë ndërkombëtare e organizuar për të gjetur zgjidhje politike të çështjes së Kosovës. Konferenca i zhvilloi



KËSHTJELLA E RAMBUJESË

punimet nga 6-23 shkurt 1999. Vendimin për ta thirrur konferencën e mori Grupi i Kontaktit për Kosovën (SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe Rusia) në Londër më 29 janar 1999. Delegacioni i Kosovës në Konferencën e Rambujesë përbëhej nga Ibrahim Rugova, president, Fehmi Agani, Edita Tahiri, Bujar Buksohi dhe Idriz Ajeti (Lidhja Demokratike e Kosovës); Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Bajram Kosumi (Lëvizja e Bashkuar Demokratike); Hashim Thaçi, Jakup Krasnqi, Azem Sylë, Xhavit Haliti dhe Ramë Buja (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) dhe Veton Surroi, botues i gazetës “Koha ditore”, si dhe Blerim Shala, botues i revistës “Zëri”. Kryetar i delegacionit të Kosovës u zgjodh përfaqësuesi politik i UÇK-së, Hashim Thaçi. Ndërkaq, delegacioni serb drejtohej nga Ratko Marković. Millosheviqi nuk erdhi vetë në Rambuje, por dërgoi një delegacion të rangut të ulët. Negociatat në Rambuje filluan me dy dokumente themelore: parimet themelore “të

panegociueshme” të caktuara nga Grupi i Kontaktit dhe me projektdokumentin e “Marrëveshjes së përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë”. Konferenca drejtohej nga ekipi ndërmjetësues ndërkombëtar, i përbërë nga përfaqësuesi i SHBA-së, ambasadori Kristofer Hill; përfaqësuesi i BE-së, ambasadori austriak Wolfgang Petritç; dhe përfaqësuesi i Rusisë, Boris Majorski. Të dy palëve iu dha projekti fillestar me parimet e panegociueshme (Non-Negotiable Principles) të hartuar nga Grupi i Kontaktit. Këto parime përmbanin marrëveshjen kornizë, aneksin kushtetues si dhe anekset për zgjedhjet dhe ombudspersonin. Këto parime theksonin shprehimisht se sovraniteti dhe tërësia territoriale e Republikës Federative të Jugosllavisë nuk cenohej, ndërsa Kosova fitonte një shkallë të lartë autonomie, me pushtetin e saj ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pas një periudhe kalimtare trivjeçare do të përcaktohej statusi përfundimtar i Kosovës. Sipas marrëveshjes, organet kryesore të Kosovës ishin Kuvendi, kryetari i Kosovës, Qeveria dhe organet administrative, të gjyqësisë dhe komunat. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, armëpushimi do të hynte në fuqi menjëherë. Të gjithë personat e kidnapuar apo personat e tjerë të burgosur pa akuzë do të duhej të liroheshin. Kapitulli për zbatimin ushtarak ishte elementi më i detajuar i gjithë marrëveshjes. Pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, të gjitha forcat e tjera do të obligoheshin të çmilitarizoheshin, duke siguruar praninë e personelit ndërkombëtar. Kapitulli ushtarak përcillej nga dy shtojca, që u bënë publike së bashku me marrëveshjen. Për kosovarët zbatimi i marrëveshjes së përkohshme nga ana e NATO-s ishte element kryesor dhe garanci se marrëveshja do të mund të realizohej. Në anën tjetër, pala serbe në asnjë mënyrë nuk ishte e gatshme të pranonte një prani të fuqishme ushtarake në Kosovë dhe aq më pak forcat ushtarake të NATO-s. Delegacioni i Beogradit kishte deklaruar se mund të merrte parasysh një prezencë ndërkombëtare me karakter civil. Sipas marrëveshjes, OSBE-ja do të ngarkohej me përgjegjësi kryesore për elementet civile të zbatimit, duke vepruar nën udhëheqjen e shefit të “Misionit zbatues”. Marrëveshja parashihte edhe dispozita për administrimin e ndihmës humanitare dhe të rindërtimit, kryesisht nëpërmjet institucioneve të Kosovës, me përfshirjen e fuqishme të Bashkimit Europian.

Me gjithë ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të sekretares amerikane të Shtetit, Medelin Olbrajt, as Kosova dhe as pala serbe nuk ishin të gatshme ta nënshkruanin marrëveshjen në kohën e caktuar, më 23 shkurt. Megjithatë, delegacioni i Kosovës, pas shumë hezitimesh, e pranoi në parim marrëveshjen, ndërsa delegacioni serb e kundërshtoi atë. Pas shumë ditë negociatash dhe presionesh mbi palët, më 23 shkurt 1999 u ndërpre Konferenca e Rambujesë, për t'i dhënë edhe një mundësi dhe kohë shtesë delegacionit serb, që ta nënshkruante "Marrëveshjen e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë." Në të njëjtën ditë, më 23 shkurt 1999, Grupi i Kontaktit i shpalli konkluzionet për ecurinë e Konferencës. Në konkluzione, mes tjerash, konstatohej se ishte arritur konsensusi për një autonomi reale për Kosovën, për mekanizmat për zgjedhjen e institucioneve demokratike, për të drejtat e njeriut dhe për krijimin e një sistemi gjyqësor. Theksohej se për negociata të mëtejshme mbeteshin të hapura çështjet e kornizës politike si dhe modalitetet e një pranie ndërkombëtare dhe ushtarake në Kosovë. Grupi i Kontaktit theksonte se palët kishin premtuar se do të merrnin pjesë në një konferencë pasuese, që do të mbulonte të gjitha aspektet e zbatimit, e cila do të mbahej më 15 mars të po atij viti. (Sylë Ukshini)

KONFERENCA PAQËSORE E DEJTONIT (1995). Konferencë paqësore e mbajtur nga 1 deri më 21 nëntor 1995 në Dejton (Ohajo), SHBA, gjatë së cilës u dha fund luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kushtet e paqes u negociuan ndërmjet përfaqësuesve të Bosnjës dhe Hercegovinës (Alija Izetbegović), Kroacisë (Franjo Tuđman) dhe Serbisë (Slobodan Milošević), me ndërmjetësimin e diplomatit amerikan Riçard Holbruk. Marrëveshja e arritur gjatë kësaj konference u nënshkrua më vonë në mënyrë solemne në Paris, më 14 dhjetor 1995. Ndonëse pati sukses në dhënien fund të luftës, konferenca është kritikuar për shkak të ndarjes etnike në Bosnjë e Hercegovinë, duke legjitimuar Republikën Serbe, si entitet me të drejtën e vetos, gjë që në vazhdim bllokoi funksionimin shtetëror të Bosnjës e Hercegovinës. (Ilir Dugolli).

KONFERENCA PAQËSORE PËR ISH-JUGOSLLAVINË (1992). Konferencë ndërkombëtare e konvokuar nga Kombet e Bashkuara

dhe Bashkimi Europian, me qëllim të arritjes së paqes në ish-Jugosllavi. Është mbajtur në Londër në gusht të vitit 1992. Në përfundim të konferencës është dënuar dhuna në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe tentimet e përfitimt të territorit me pushtime. Pjesëmarrësit e konferencës kanë kërkuar dhënien fund të armiqësive dhe të dhunës, njohjen e Bosnjës dhe të Hercegovinës si shtet nga të gjitha ish-republikat jugosllave dhe respektimin e kufijve të shteteve të reja, që u krijuan pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Pjesëmarrësit e konferencës po ashtu kërkuan nga palët që të zhvillojnë negociata për të ardhmen kushtetuese të vendit. (Ilir Dugolli)

KONGRESI ARSIMOR KOMBËTAR I LUSHNJËS (1920). Kongres që përcaktoi fizionominë e arsimit në shtetin e pavarur shqiptar. Kishte synim njësimin e organizimit të shkollës dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. U mbajt më 15 gusht 1920, sipas kërkesave të përcaktuara nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës. Kongresi trajtoi problemet e sistemit arsimor, të strukturës dhe të përmbytjes së shkollës, të njësimin të gjuhës në tekstet shkollore, çështje didaktike dhe praktike të punës në shkollë. I zhvilloi punimet në bazë të një programi, pikat kryesore të të cilit ishin hartuar nga Ministria e Arsimit, nën drejtimin e Sotir Pecit. Ai vendosi që sistemi arsimor të shtrihej në të gjitha krahinat e vendit të çliruar nga ushtritë ndërluftuese të Luftës së Parë Botërore. Sipas vendimit, arsimit fillor të bëhej falas dhe i detyrueshëm. Nivelet e klasave u caktuan: 4-5 klasa në qytet dhe 3 klasa në fshat, ndërkaq viti shkollor do të fillonte më 15 shtator dhe do të mbaronte më 30 qershor. Shkollat private u detyruan të punonin mbi bazën e programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe t'i nënshtroheshin kontrollit të saj. Kongresi mori vendime edhe për sigurimin e kuadrit arsimor vendës, njësimin e programeve të shkollave, formimin e një komisioni për përgatitjen e teksteve shkollore, futjen e gjuhës së huaj në klasën e tretë fillore etj. Kongresi Arsimor Kombëtar i Lushnjës diskutoi edhe për çështje didaktike dhe praktike të punës në shkollë. U larguan termat e huaj dhe u miratuan afër 250 terma për gjuhën, aritmetikën dhe gjeometrinë. Me këto çështje u vendos të merrej Komisia Letrare, e cila u mëkëmb në kuadër të Ministrisë së Arsimit më 30 shtator 1920, nën kryesinë e

A. Xhuvanit dhe me anëtarë S. Çekën e M. Logorecin. Kongresi i miratoi edhe vendimet e Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1918) për gjuhën letrare dhe drejtshkrimin e saj mbi bazën e elbaskanishtes. Në këtë kongres u përcaktua fizionomia e arsimit në shtetin e pavarur shqiptar. (Shkumbin Munishi)

KONGRESI I BERLINIT (1878). Mbledhje e Fuqive të Mëdha, për të arritur marrëveshje për zhvlerësimin e vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878). Kongresi filloi punimet



KONGRESI I BERLINIT (1878)

më 13 qershor 1878, në të cilën morën pjesë Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia, Rusia dhe Austro-Hungaria. Aty u mbajtën 20 seanca dhe gjatë tërë kohës punimet u zhvilluan në ndërtesën e Raihs-kancelarit në Wilhelmstrase në Berlin. Në Kongres Gjermania përfaqësohej nga kancelari Oto fon Bismark, ndërsa shtetet e tjera përfaqësoheshin kryesisht nga kryeministra ose ministra të Jashtëm, bashkë me ambasadorë dhe zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë. Delegacioni i Perandorisë Osmane mund të diskutonte për pikat e rendit të ditës, por nuk kishte të drejtë vote. Edhe shtetet ballkanike, si: Serbia, Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Mali i Zi kishin të drejtë të shfaqnin para Kongresit kërkesat politike dhe territoriale. Pas diskutimeve të ashpra ndërmjet delegacioneve, në seancën e pestë dhe të gjashtë u pranua propozimi i Austro-Hungarisë që Rusia brenda gjashtë muajsh të largohej nga Rumelia Lindore, brenda nëntë muajsh të largohej edhe nga Bullgaria, e cila u nda në dy pjesë. Rusia duhej të largohej edhe nga Rumania brenda dymbëdhjetë muajsh. Fuqitë e Mëdha e nënshkruan një Traktat të ri, i cili u quajt “Traktati i Berlinit”. Vendimi

i Kongresit për një principatë bullgare mbeti në fuqi, por kjo principatë nuk do të shtrihej në kufijtë e planifikuar sipas Traktatit të Shën Stefanit. Viset në jug të maleve në Ballkan do të formonin një provincë autonome të Perandorisë Osmane, e cila do të quhej Rumelia Lindore. Viset e Maqedonisë, së bashku me krahinat lindore të Shqipërisë, do të mbeteshin edhe më tej nën sundimin e Perandorisë Osmane. Në Berlin u njoh pavarësia Serbisë, Malit të Zi dhe Rumanisë. Austro-Hungaria fitoi të drejtën për të pushtuar Bosnjë dhe Hercegovinën dhe për të mbajtur garnizone ushtarake në sanxhakun e Pazarit të Ri. Kurse Britania e Madhe, e cila njihej si përkrahëse e Perandorisë Osmane, i shkëputi kësaj të fundit ishullin e Qipros. Në protokollin XIII bëhej fjalë për “privilegjet e popullsisë katolike të Mirditës”. Kjo u bë me iniciativën e Francës dhe Austro-Hungarisë. Në Kongres u morën vendime, sipas të cilave disa territore shqiptare u njoheshin fqinjëve: Serbia merrte krahinat e Vranjës, të Nishit, Prokuplës dhe zonat e tjera të vilajetit të Kosovës; Malit të Zi do t’i kalonin Plava, Gucia dhe krahinat e tjera të vilajetit të Shkodrës. Krahinat në jug të tokave shqiptare u vendos të zgjidheshin me bisedime greko-turke. Kongresi rekomandonte si kufi vijën Selevira në Thesali, për të vazhduar në rrjedhën e lumit Kallama në vilajetin e Janinës. (Jusuf Bajraktari)

KONGRESI I DIBRËS (1909). Kongres i organizuar me nismën e Komitetit Qendror “Bashkim dhe përparim” në Dibër më 23-29 korrik 1909. Duke dashur t’i jepnin Kongresit karakter të përgjithshëm osman, xhonturqit ftuan të merrnin pjesë në këtë tubim jo vetëm shqiptarët, por edhe kombësitë e tjera të vilajeteve të Turqisë Europiane. Në Kongres morën pjesë 325 delegatë, shumica e të cilëve ishin shqiptarë, por kishte edhe delegatë turq, maqedonë, grekë, serbë e vllah. Edhe pse shumica e delegatëve ishin përkrahës të xhonturqve, në Kongres morën pjesë edhe një numër përfaqësuesish të forcave patriotike të Lëvizjes Kombëtare, të dërguar nga klubet e shoqëritë atdhetare, midis të cilëve edhe: Vebi Dibra, Sotir Peci, Dervish Hima, Fehim Zavalani, Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Andrea Ballamaçi, Qazim Beu (kryetar i Klubit “Bashkimi” të Dibrës) etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Vehbi efendi Dibra, myfti i këtij

sanxhaku, që ishte një nga personalitetet më me ndikim në trevat shqiptare. Xhonturqit u orvatën t'u impononin delegatëve programin e vet prej katër pikash, thelbi i të cilit ishte osmanizimi i shqiptarëve dhe i popujve të tjerë kundër regjimit absolutist. Kongresi me këmbënguljen e patriotëve shqiptarë miratoi një program prej 17 pikash. Pjesa e parë prej 5 pikash ngërthente karakterin xhonturk, ndërsa në pjesën e dytë të programit prej 12 pikash, delegatët shqiptarë kërkuan që në shkollat që do të hapeshin në Shqipëri, gjuha shqipe të mësohej lirisht. Me këmbënguljen e shqiptarëve u kërkua që “në emërimin e nëpunësve t'u jepet përparësi banorëve vendas, që njihnin karakterin dhe zakonet e vendit, si dhe të njiheshin gjuha e vendit në komunitetet fetare”. Kongresi i Dibrës pati rëndësi për qëndresën e vendosur që delegatët shqiptarë bënë kundër programit osmanist të xhonturqve dhe për parashtrimin e kërkesave kombëtare në fushën e arsimit. Me gjithë përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë për të mbrojtur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar dhe me gjithë disa ndryshime që ata i bënë programit fillestar të xhonturqve, Kongresi i Dibrës nuk arriti të kthehej në një manifest të pavarur kombëtar. Atdhetarët shqiptarë, të prirë nga Dervish Hima, e kthyen Kongresin e Dibrës kundër reaksionit xhonturk dhe për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar. (Nebi Dervishi)

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT (1972).

Mbledhje shkencore gjithëkombëtare e njohur si Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, mbajtur nga 20-25 nëntor 1972 në



PJESËMARRËS TË KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT, TIRANË 1972

Tiranë, me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Universitetit Shtetëror

të Tiranës. Ishte kurorëzim i përpjekjeve që u bënë pas Luftës së Dytë Botërore për standardizimin e gjuhës shqipe. Vlerësohet si ngjarje me interes të madh kombëtar. Në të morën pjesë 87 delegatë dhe mbi 300 të ftuar të tjerë nga viset e ndryshme ku flitet shqipja: nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Italia, Greqia etj. Ndërmjet tyre kishte studiues dhe pedagogë të gjuhës shqipe, mësues, shkrimtarë, publicistë, botues, veteranë të arsimit dhe të kulturës etj. Synimi i mbledhjes së Kongresit ishte përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve kryesore për hartimin e rregullave të drejtshkrimit, për të pasur një gjuhë letrare të njësuar kombëtare. Ky Kongres, si forumi më i lartë shkencor, analizoi dhe diskutoi gjerësisht parimet themelore, çështjet e përgjithshme dhe shumë zgjidhje të veçanta të drejtshkrimit të shqipes, si dhe probleme të tjera teorike e praktike, që kanë të bëjnë me normën letrare në përgjithësi. Në Kongres u mbajt një referat qendror me temën “Gjuha letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj” (Androkli Kostallari) dhe mbi 150 kumtesa e referime shkencore (gjithë materialet e Kongresit janë botuar në dy vëllime: “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe” I, II (Tiranë, 1973). Pas diskutimeve të gjera në seanca plenare dhe në dy seksione, Kongresi miratoi njëzëri “Rezolutën”, që është një sintezë e mendimit dhe e vullnetit të përbashkët të njerëzve të shkencës, të shkollës dhe të kulturës shqiptare. Kongresi zgjidhi çështjen e njësimit të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. Parim themelor i drejtshkrimit të shqipes u vendos parimi fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen ashtu siç shqiptohen, me qëllim vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare. Krahas tij u vendos që drejtshkrimi të mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik, i cili kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore që shkaktohen nga ligjet fonetike që veprojnë sot në gjuhë. Gërshetimi i parimit fonetik me parimin morfologjik në drejtshkrimin e shqipes plotësohet edhe nga zbatimi i disa parimeve të tjera, siç janë parimi historik-traditional për rastet që kanë një traditë shkrimi të vjetër, të ngulitur prej kohësh, ai leksiko-semantik etj. Fushat e zbatimit të këtyre parimeve janë më

të ngushta dhe përfshijnë anë të veçanta të drejtshkrimit. Sipas kërkesave të Kongresit, janë hartuar tashmë “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori drejtshtkrimor i gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe”, “Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe” etj. Bazë e gjuhës standarde shqipe në Kongresin e Drejtshkrimit është zgjedhur toskërishtja, e plotësuar me disa elemente të gegërishtes. Kjo gjuhë standarde përdoret sot si gjuhë zyrtare, kryesisht si gjuhë shkence, shkolle, letërsie, administrate, të medias dhe në fusha të tjera publike në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës, gjuhë zyrtare e shqiptarëve në Serbi, në Maqedoni, në Mal të Zi, e arbëreshëve në Itali etj. (Shkumbin Munishi)

KONGRESI I LIPOVICËS (BLINAJËS) (1946). Kongres i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH), i mbajtur më 25 korrik 1946 në fshatin Lipovicë (Blinajë) të Lipjanit. U thirr me kërkesën e krerëve të LNDSH-së: Ajet Gërguri, Gjon Serreçi, Azem Morana, Qemajl Skënderi etj. Prej gjithsej rreth 230 delegatëve të thirrur, në Kongres kishin arritur rreth 150 delegatë, të cilët përfaqësonin mbi 30.000 anëtarë të LNDSH-së. Disa nga delegatët kishin arritur në Blinajë më 24 korrik. Punimet e Kongresit i hapi Ilmi Zariqi, i cili në emër të një grupi delegatësh në kryesinë e punës propozoi Ajet Gërgurin, Gjon Serreçin dhe Hasan Bilallin, ndërsa për procesmbajtës propozoi Ukë Plakiqin. Në seancën e parë të Kongresit, sipas rendit të ditës të miratuar nga të gjithë delegatët, u lexuan tri referate. Referatin e parë, që ishte një raport për gjendjen në viset e pushtuara shqiptare, e paraqiti Ajet Gërguri, Gjon Serreçi foli për rolin dhe rëndësinë e LNDSH-së, ndërsa Arif Shala për rëndësinë e Luftës së Drenicës nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës. Më pas delegatët paraqitën kushtet dhe vështirësitë me të cilat ballafaqoheshin në terren. Në seancën e dytë Kongresi miratoi dy rezoluta: në rezolutën e parë kërkohej nga SHBA dhe Britania e Madhe jetësimi i vendimeve të Konferencës së Bujanit, ndërsa me rezolutën e dytë kërkohej krijimi i Ushtrisë Popullore Shqiptare të Kosovës, emërimi i shtabit suprem prej 8 anëtarësh dhe i komandantit të përgjithshëm. Kongresi gjithashtu zgjodhi Komitetin Qendror të

LNDSH-së prej 27 anëtarësh. Pas kongresit u mbajt mbledhja e parë e Komitetit Qendror të LNDSH-së, në të cilën me vota të hapura kryetar u zgjodh Ajet Gërguri, zëvendës Hasan Bilalli, sekretar i përgjithshëm Gjon Serreçi. Po me këtë rast u zgjodh edhe Byroja Politike prej 4 anëtarësh, ku bënë pjesë: Ajet Gërguri, Gjon Serreçi, Arif Shala dhe Hilmi Zariqi. Në kuadër të Komitetit Qendror u zgjodhën edhe 4 komisione profesionale dhe organe të përhershme ekzekutive: 1. Komisioni për mbrojtje dhe siguri kombëtare; 2. Komisioni për marrëdhënie me botën e jashtme; 3. Komisioni për informim, propagandë dhe agjitim; dhe 4. Komisioni për financa, ekonomi dhe furnizim. Edhe përkundër faktit se kongresi u zhvillua në ilegalitet, pjesëmarrësit u dekonspiruan shpejt dhe shumë shpejt pasoi ndjekja, likuidimi, burgosja dhe dënimi me shumë vite burg, pothuaj i të gjithë pjesëmarrësve dhe udhëheqësve të LNDSH-së. (Fehmi Rexhepi)

KONGRESI I MANASTIRIT (1908). Kongres i njësitit të alfabetit të gjuhës shqipe. I zhvilloi punimet prej 14-22 nëntor 1908. Nismëtar i këtij Kongresi ishte klubi “Ba-



PJESËMARRËSIT E KONGRESIT TË MANASTIRIT (1908)

shkimi” nga Manastiri, i cili në gusht të atij viti mori vendim që të mbahej një kongres gjithëkombëtar për të vendosur për unifikimin alfabetit të shqipes. Ky Kongres hyri në histori si Kongresi i Manastirit. Kjo lëvizje kulturore e shqiptarëve u bë e mundur vetëm pas krijimit të rrethanave të reja politike në Perandorinë Osmane (Shpallja e Kushtetutës së Hyrjetit). Çështja themelore në këtë Kongres ishte njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe, çështje që në ato vite ishte shndërruar pothuajse në një problem politik, kulturor e arsimor. Në

Kongres morën pjesë 50 delegatë, përfaqësues të 23 shoqërive e klubeve shqiptare brenda dhe jashtë vendit, ndër ta kishte shkrimtarë, gazetarë, mësues të shqipes, veprimtarë të shquar të lëvizjes kulturore e kombëtare, por e drejta e votës iu pranua vetëm 32 delegatëve. Punimet e Kongresit të Manastirit zgjatën nëntë ditë. Në seancat plenare morën pjesë rreth 400 pjesëmarrës, me ç'rast u aprovuan dy vendime: baza e alfabetit të përbashkët për të gjithë shqiptarët do të jetë latine dhe formimi i një komisioni të përbashkët prej 11 anëtarësh, që përbëhej nga përfaqësues të tri alfabeve kryesore që ishin në përdorim. Në këtë Komision bënë pjesë: Gjergj Fishta (kryetar), Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mithat Frashëri, Shahin Kolonja, Dhimitër Buda, Ndre Mjeda, Gjeraj Qiriaz, Bajo Topulli, Nyzhet Vrioni dhe Grigor Cilka. Pjesëmarrësit e tjerë qenë betuar se do të respektonin vendimet e këtij Komisioni pa vërejtje. Komisioni punoi tri ditë rresht (17-19 nëntor 1908) me detyrë të mbyllura. Pas shumë diskutimesh, ky komision krijoi një alfabet të ri, i tëri i mbështetur në alfabetin latin, shkronjat e të cilat plotësoheshin me nëntë dyshkronjësja (dh, gj ll, zh, th, rr, nj, xh, sh) dhe me dy shkronja me shenja diakritike (ç, ë). Më 20 nëntor 1908 Komisioni shpalli vendimet përfundimtare. Kongresi mori vendim që të përdorej Alfabeti i Stambollit, siç u tha, për nevojat e komunikimit kombëtar dhe njëkohësisht miratoi një alfabet të ri latin, përmes të cilit do të botoheshin librat në gjuhën shqipe. Alfabeti latin për pak vjet u bë mbizotërues në shkallë kombëtare dhe e la jashtë përdorimit Alfabetin e Stambollit. Vendimet e Kongresit të Manastirit u përkrahën dhe u mirëpritën nga të gjitha rrethet intelektuale e kulturore shqiptare brenda dhe jashtë vendit. U cilësuan si kurorëzime të përpjekjeve të shumë brezave lëvruarish të shqipes për njësimin e një alfabeti dhe si një hap përpara drejt njësimin të drejtshkrimin dhe të gjuhës letrare shqipe. Kongresi pati rëndësi jo vetëm për njësimin e alfabetit të shqipes, por u shfrytëzua nga delegatët e shumtë nga të gjitha viset shqiptare për të hartuar një platformë të përbashkët politike të të gjitha organizatave kombëtare për të bashkërenditur më mirë veprimtarinë e tyre. U hartua edhe një program kërkesash politike, kulturore e ekonomike prej 18 pikash dhe iu dorëzua deputetit të Korçës, Shahin Kolonja, për ta paraqitur në parlamentin turk në emër

të të gjithë shqiptarëve. Kongresi i Manastirit i përfundoi punimet më 22 nëntor 1908. (Bahri Koskoviku)

KONICA Faik (1876-1942). Shkrimtar poligraf, eseist, kritik letrar, polemist e publicist. Është një nga personalitetet pararendëse e themelore të kulturës moderne kombëtare.



FAIK KONICA

Pinjoll i një dëre të vjetër aristokracie lindore, lindi në Konicë. Mësimet e para i mori në vendlindje gjuhë të Lindjes dhe greqisht, përveç një viti studimor në shkollën jezuite në Shkodër më 1884, kur ishte 11 vjeç. Vijoi në Liceun Perandorak të Stambollit dhe nga viti 1890 nisi shkollimin e mesëm në Francë, ku përfundoi edhe Universitetin e Dizhonit për letërsi e filozofi. Në Paris ndoqi Kolegjin e Francës për letërsi frënge të Mesjetës, si dhe greke e latine. I përkufizuar si "student i përjetshëm", më 1912 mori gradën "Magjistër i artit e letërsisë" në Universitetin e Harvardit. Njohës i rrallë i shumë gjuhëve ai përktheu pak dhe botoi vetëm një përmbledhje "Nën hijen e hurmave, Pralla t'arabisë" (Boston, 1924), përkthim rikrijues nga anglishtja i "Një mijë e një netëve". Polemikë erudite në frëngjishte elegante e përfshinë herët në debate të kulturës moderne europiane. Mëk dhe mecen i poetit G. Apollinaire, Konica shfaqet edhe si personazh shqiptar i admirueshëm e ekstravagant në shkrimet e tij. Aktiviteti poliedrik i Konicës lidhet me ngritjen e vetëdijes kulturore e politike kombëtare në një nivel të ri. Spikat themelimi i revistës "Albania", revistë avangardë shqip-frëngjisht e më pak turqisht. Aty F. Konica shpalosi vetëdijen kritike, hapi debatin mbi çështjet e njësimin të shqipes letrare dhe themeloi kritikën letrare shqipe mbi parime moderne, si shprehje e subjektivitetit, kërkimit estetik dhe ligjësisive të brendshme të artit. Prej nr. 1 të 25 marsit 1897 në Bruksel, ku u botua deri në mes të 1902, e mandej në Londër deri më 1909, "Albania" qe fryt i vizionit të Konicës dhe i një refleksioni të gjatë për çështjen kombëtare shqiptare. Me mbylljen e saj u vendos në SHBA, ku vijoi me botimin e gazetave "Dielli" dhe "Trumbeta e Krujës". Në Boston, me Fan Nolin, themeloi

Federatën Pan-Shqiptare “Vatra” të Amerikës, u bë kryeredaktor i “Diellit” dhe sekretar i “Vatrës”, e më pas kryetar (1921). Aktivitetin politik, efikas por dhe emocional e kontradiktor e vijoi më së shumti në diplomaci, ku spikat si ministër i Shqipërisë në SHBA, i emëruar nga A. Zogu më 1926, kur Konica pranoi “humbjen” e sprovës Noliene së cilës i ishte bashkuar. Vdiq më 1942 me amanetin e varrosjes në atdhe, por kjo mbeti e pamundur deri me ndryshimet demokratike shqiptare. Nga viti 1995 prehet në Memorialin e Rilindasve në Tiranë.

Pjesa dërrmuese e krijimtarisë letrare të F.Konicës u botua në të përkohshme. Kjo ka ndikuar edhe natyrën e shkrimeve të tij. Pak proza poetike, fine në përjetime subjektive dhe gjuhë, shenjojnë modelin e parë në letrat shqipe. Tregimi alegorik “Një ambasadë e zulluve në Paris” (“Dielli”, 1922) dhe proza fejton “Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit” (“Dielli”, 1924) sjellin një ndryshim konceptual të prozës drejt modernitetit; politikja e individuale kundrejt kolektives, kirurgjia e mprehtë e satirës dhe zhdërvjelltësia e gjuhës sprovajnë me sukses vetëdijen kritike e estetike të shkrimit përtej patosit etik romantik. Qoftë në trajta të shkurtra e deri te ato të gjatat e më sistematike si “Shqipëria si m’u duk” (“Dielli”, 1929) dhe dorëshkrimi anglisht “Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës Juglindore” (Albania, the rock garden of Southeastern Europe), botuar pas vdekjes (Boston, 1957), eseja e tij ndërton përmes shkrimit elegant një univers kulturor autentik të botës shqiptare. Falë edhe bashkëkohësisë së veprës së vet, konsiderohet figurë qendrore e letërsisë dhe kulturës moderne shqipe. (Persida Asllani)

KONKURSI I DRAMËS “KATARINA JO-SIPI”. Konkursi i përhershëm i Teatrit Popullor Krahinor dhe më pas i Teatrit Kombëtar të Kosovës për dramë origjinale, me qëllim të nxitjes së krijimtarisë dramaturgjike. Konkursi, me emrin e aktores së njohur, u themelua në vitet ’70. Me këtë konkurs iu dha një mbështetje shkrimit të dramës origjinale shqipe nga autorët shqiptarë, për të mbuluar zbrazëtinë e dramaturgjisë bashkëkohore shqipe. Gjatë kohës së funksionimit të këtij konkursi (vitet ’70 dhe ’80), emra të njohur krijuesish letrarë dhe teatrore morën çmime me tekstet e tyre, ndër të cilët: Ymer Shkreli,

Teke Dërvishi, Jusuf Buxhovi, Atdhe Gashi, Flamur Hadri, Mehmet Kraja etj. Për shkak të rrethanave politike dhe sociale në fundvitet ’80 konkursi pushoi së ekzistuari. Me të njëjtin emër, ky konkurs u riaktivizua në vitin 2008, me vendim të Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit të Republikës së Kosovës. Që nga ajo kohë Ministria e Kulturës shpall thirrjet për aplikim për dramën origjinale shqipe për çdo vit kalendarik. Në bazë të rregullave të konkursit, drama fituese vihet në skenën e Teatrit Kombëtar të Kosovës, ndërsa tri dramat fituese botohen në një vëllim të përbashkët. (Arian Krasniqi)

KONKURRENCA. Gjendje në të cilën tregtia e lirë dhe zgjedhja e lirë e konsumatorëve kanë rol mbisundues në jetën ekonomike. Format kryesore të konkurrencës janë: konkurrenca në bazë të çmimeve, konkurrenca në bazë të inovacioneve, konkurrenca përmes monopolit, konkurrenca efektive dhe konkurrenca joefektive. Konkurrenca efektive paraqet luftën midis rivalëve afaristë në treg, ku të gjithë pjesëmarrësit bëjnë përpjekje për të mbijetuar. Kjo konkurrencë vepron më së shumti në bazë të çmimeve. Në praktikën ekonomike ndeshemi edhe me konkurrencën joefektive, kur një ose më shumë firma e dominojnë një treg të caktuar, të cilat diktojnë kushtet e konkurrencës dhe nëpërmjet çmimeve eliminojnë rivalët e tyre në treg. Në Kosovë, si pjesë e ish-Jugosllavisë, konkurrenca ka ekzistuar kryesisht në tregun e mallrave dhe të shërbimeve, por jo në tregun e kapitalit dhe të fuqisë punëtore. Pas rënies së mënyrës socialiste të prodhimit, konkurrenca filloi të depërtojë edhe në tregun e kapitalit dhe të fuqisë punëtore, si forma të tregut integral. Së fundi, ligji mbi konkurrencën ka vënë bazat e mbrojtjes së konkurrencës së lirë në Kosovë, duke institucionalizuar, ndër të tjera, detektorin kryesor të sjelljeve abuzive lidhur me konkurrencën e lirë, e që është Autoriteti Rregullues i Konkurrencës. (Sinan Ademaj)

KONSTANTINI I MADH. Perandor romak me origjinë dardane (306-337). Lindi në Naissus (Nish), si djalë i Konstantinit I, oficer i ushtrisë romake dhe i Helenës. Sundimi i tij shënon epokë të veçantë në historinë e Perandorisë Romake, që ndikoi edhe në rrjedhat e zhvillimit botëror. Pasi babai i tij u bë zëvendësperandor në përfundim (293), u dërgua dhe u edukua

në oborrin e perandorit Dioklecian. U shpall perandor nga ushtria në Eburacum (York), pas vdekjes së babait në vitin 306 dhe doli fitimtar në një varg luftërash civile kundër perandorëve Maxentius dhe Licinius. Në vitin 324 u bë sundimtar i vetëm i territoreve romake të perëndimit dhe të lindjes. Për ta forcuar perandorinë bëri reforma administrative, financiare, sociale dhe ushtarake, duke e ristrukturuar qeverinë dhe duke e bërë ndarjen e autoritetit civil dhe ushtarak. Nxori monedhë të re ari (solidus) për ta luftuar inflacionin dhe kjo u bë monedhë standarde për më shumë se një mijë vjet. Luajti rol vendimtar në shpalljen e Ediktit të Milanit (313), i njohur dhe si Edikti i Tolerancës dhe është perandori i parë romak me besim të krishterë. Në vitin 325 organizoi Koncilin e Nikesë, në të cilin u vendosën bazat doktrinare të krishterimit. Konstantini ndërtoi dhe rezidencën e re perandorake në Bizant dhe e quajti sipas vetes Konstantinopol. Iu dha dhe epiteti si themelues i “Romës së Re”, e cila më vonë u bë kryeqytet i Perandorisë Bizantine për më shumë se njëmijë vjet. (Arben Arifi)

KONSULTA GJUHËSORE E PRISHTINËS (1968). Mbledhje shkencore për probleme të ndryshme të gjuhës shqipe, të standardit dhe të drejtshkrimit të saj, e mbajtur më 22 dhe 23 prill 1968 në Prishtinë. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës u organizua nga Instituti Albanologjik dhe katedra e gjuhës dhe e letërsisë Shqipe e Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Morën pjesë 150 intelektualë të fushave të ndryshme. Kjo mbledhje kishte për qëllim të merrte qëndrim për fatin e shqipes letrare në Kosovë dhe në vise të tjera ku jetonin shqiptarët etnikë në ish-Jugosllavi dhe t’i diskutonte Rregullat e drejtshkrimit (projekt) të vitit 1967. “Ortografia e gjuhës shqipe” (projekt) e 1967-s sanksionoi një gjuhë të përbashkët letrare shqipe. Fjalën hyrëse e mbajti drejtori i Institutit Albanologjik, Fehmi Agani, ndërsa Idriz Ajeti lexoi referatin “Rruga e njësimi të gjuhës letrare shqipe dhe ortografisë së re”, që u botua edhe në të përditshmen “Rilindja” në prill të vitit 1968. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës i zhvilloi punimet gjatë dy ditëve, ku u bënë diskutime të gjera nga gjuhëtarë, shkrimtarë, arsimtarë e punëtorë të tjerë të arsimit, të shkencës e të kulturës shqiptare të Kosovës e të Maqedonisë. Në ditën e dytë Konsulta Gjuhësore e Prishtinës

miratoi konkluzat, të cilat në historinë e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe kanë hyrë me emrin Konkluzat e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968). Në këto konkluzat u miratua vendimi që edhe shqiptarët e këtyre anëve ta shkruanin dhe ta flitnin gjuhën letrare kombëtare që flitej e shkruhej në Shqipëri. U vendos që deri në një vendim të ri të zbatohet “Projekti i ortografisë” i vitit 1967. Vërejtjet që iu bënë këtij projekti iu dërguan Universitetit Shtetëror të Tiranës. Instituti Albanologjik dhe katedra e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e Fakultetit Filozofik të Prishtinës u autorizuan t’u rekomandonin institucioneve dhe enteve arsimore dhe pedagogjike, gazetave, shtëpive botuese etj., të krijojnë mundësi për zbatimin sa më të shpejtë të konkluzave të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës. Pjesëmarrësit e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës e përkrahën mendimin që ortografia e 1967-s të aprovojë dhe të zbatohet edhe në Kosovë e në vise të tjera të banuara me shqiptarë, për formimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe, e cila do të shërbente për komunikim gjithëkombëtar. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës konsiderohet ngjarje e rëndësishme kombëtare drejt rrugës së standardizimit të gjuhës shqipe. Konsulta Gjuhësore ishte diskutimi i parë ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë për çështje të planifikimit të gjuhës që po mbahej vetëm nën përkujdesjen e institucioneve shkencore-kulturore, pa përzjerje të organeve të pushtetit. (Shkumbin Munishi)

KONSUMI PUBLIK. Vlera e produkteve dhe e shërbimeve që marrin qytetarët nga sektori publik. Konsumi publik përfshin kryesisht shpenzimet që bëhen nga qeveria e vendit për nevojat e përgjithshme të qytetarëve në fushën e shërbimeve publike. Pjesa më e madhe e shpenzimeve publike është e orientuar drejt infrastrukturës publike, pensione, ndihmave sociale, sigurisë publike, shëndetësisë dhe arsimit. Shpenzimet publike luajnë rol të rëndësishëm në stabilizimin e kërkesës agregate dhe të shpërndarjes së të ardhurave në ekonomi. Shpenzimet publike mund të klasifikohen në bazë të produkteve dhe shërbimeve nga orientohen ato, siç janë shpenzimet publike kapitale, shpenzime publike në konsum dhe shpenzime të personelit. Së dyti, ato mund të klasifikohen sipas nivelit qeverisës të shpenzimit (shpenzime publike qendrore,

lokale apo të organizatave të pavarura publike). Shpenzimet publike mund të klasifikohen edhe sipas funksionit, pra ku orientohen ato. Në Kosovë në vitin 2014 shpenzimet publike arritën vlerën prej 1.5 miliardë euro, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin 2013. Zakonisht shpenzimet publike paraqiten si përqindje e prodhimit të brendshëm bruto dhe në rastin e Kosovës ato arrijnë nivelin rreth 30% të këtij prodhimi. (Alban Zogaj)

KONSUMI. Përfshin shpenzimet që bëjnë konsumatorët për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, pothuajse gjithçka që blejnë konsumatorët, nga produktet e prekshme deri te shërbimet e paprekshme. Përfshijmë nga konsumi mund të llogariten blerjet e mallrave kapitale, si shtëpitë e reja, të cilat mund të konsiderohen si investime, për shkak se këtyre aseteve mund t'u rritet vlera në të ardhmen. Konsumi është një prej përbërësve kryesorë të kërkesës agregate. Faktori vendimtar që ndikon në ndryshimin e konsumit janë të ardhurat e konsumatorit. Sa më të larta të jenë të ardhurat e konsumatorëve, aq më i lartë do të jetë konsumi i përgjithshëm në ekonomi. Në vitin 2012 në Kosovë konsumi i përgjithshëm ka qenë 5,25 miliardë euro, kurse në vitin 2013 konsumi i përgjithshëm ka qenë 5,39 miliardë euro. Ekonomia e Kosovës aktualisht ka nivel të lartë të konsumit në prodhimin e brendshëm bruto. (Alban Zogaj)

KONTABILITETI. Proces sistematik dhe gjithëpërfshirës i regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave financiare të një subjekti afarist, me ç'rast informatat financiare mbi biznesin identifikohen, regjistrohen, përmbledhen, interpretohen dhe u komunikohen pronarëve, menaxherëve dhe palëve të tjera të interesuara. Kontabiliteti është strukturë e koncepteve dhe e teknikave që shfrytëzohen për matjen dhe raportimin e informatave financiare për subjektin afarist. Kontabiliteti përfshin dy disiplina: kontabilitetin financiar dhe kontabilitetin e menaxhmentit. Kontabiliteti financiar ka të bëjë me informatën kontabël, që u komunikohet përdoruesve të jashtëm të informatës. Kontabiliteti financiar është ajo pjesë e sistemit të kontabilitetit që merret me matjen dhe raportimin e gjendjes financiare dhe të rezultatit të biznesit gjatë një periudhe të caktuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financi-

ar, të cilat zbatohen edhe në Kosovë. Kontabiliteti i menaxhmentit ka të bëjë me të gjitha llojet e informatës kontabël, që grumbullohen, maten, regjistrohen, përpunohen dhe u transmetohen menaxherëve të subjektit afarist. Pasi menaxherët janë të ngarkuar me planifikimin në biznes, në kontrollin dhe marrjen e vendimeve, kontabiliteti i menaxhmentit u siguron atyre informacionet që kanë të bëjnë me koston e produkteve të prodhuara në tërësi për produkte të veçanta dhe në çdo segment të njësisë, me planifikimin dhe me kontrollin e operacioneve të ndryshme, me sasinë e të ardhurave për çdo produkt dhe segment të njësisë, me buxhetimin e kapitalit dhe informacionet e tjera financiare për marrjen e vendimeve menaxheriale. (Skender Ahmeti)

KONTRABANDIMI. Pjesë e krimit të organizuar. Përkufizohet si gjendje ku individët dhe grupet e caktuara, duke mos e përfillur ligjin dhe duke bërë vepra kriminale të sanksionuara me ligjet përkatëse, synojnë të realizojnë përfitime të ndryshme, të shumtën përfitime materiale. Kontrabandimi tradicional shtrihet tek ato mallra që kanë normë të lartë të tatimit (cigaret, pijet alkoolike, produktet e industrisë farmaceutike, nafta dhe derivatet e saj etj.). Kontrabandimi modern shtrihet në fushën trafikimit të qenieve njerëzore. Kontrabandistët e fuqisë punëtore (të popullsisë aktive), siç ndodh në Kinë, i dërgojnë emigrantët deri në vendet e caktuara, por nuk u premtojnë vende të punës. Viktimat e trafikimit ose rrëmbehen, ose mashtrohen nga trafikantët, në bashkëpunim me punëdhënësit, qëllimi i të cilëve është skllavërimi dhe eksploatimi i tyre. Pavarësisht nga format e paraqitjes së kontrabandimit, ky fenomen është më i theksuar në vendet në konflikt ose pas konfliktit të armatosur. Pas luftës ky fenomen është paraqitur në pjesën veriore të Kosovës, veçanërisht në fushën e tregtisë ilegale me mallra të akcizës. Në kohë të fundit u shfaq edhe një eksod i theksuar i popullsisë aktive, i cili është një simbiozë e kontrabandimit dhe e trafikimit. (Selman Selmanaj)

KONTROLLI BUXHETOR. Një teknikë monitoruese, nëpërmjet së cilës të hyrat dhe shpenzimet aktuale krahasohen me të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara paraprakisht. Shërben si vegël e verifikimit të progresit financiar dhe për identifikimin e ndërhyrjeve eventuale. Kontrolli buxhetor dallon nga kontrolli

financiar: përderisa i pari mat progresin e ekzekutimeve buxhetore, ky i fundit bën auditimin dhe vërtetësinë e shpenzimeve financiare. Në rastin e Kosovës kontrolli buxhetor bëhet nga Ministria e Financave dhe Kuvendi, veçanërisht nga komisioni për buxhet e financa dhe komisioni për mbikëqyrjen e financave publike. (Lumir Abdixhiku).

KONTROLLI FINANCIAR. Është përcaktues nëse bëhet respektimi i kushteve ligjore (në rastin e financave publike) dhe normative (në rastin e financave private). Kontrolli financiar mund të ushtrohet para ngjarjes financiare dhe pas saj. Kontrolli paraprak financiar, i bërë në kushtet e respektimit të ligjit dhe të normativës, paraqet mundësinë e parandalimit të gabimeve, kurse kontrolli prapavajtës ka për qëllim evidentimin e respektimit të kushteve ligjore dhe normative nga vendimmarrësit financiarë. Në kuadër të kontrollit financiar hyjnë edhe proceset e auditimit. Auditimi mund të jetë i brendshëm dhe i jashtëm. Auditimi i brendshëm është mekanizëm për zbatimin e ligjshmërisë, merr rol në përmirësimin e proceseve financiare dhe ka efekt parandalues. Auditimi i jashtëm është mekanizëm financiar prapavajtës, i cili konstaton zbatimin e kushteve ligjore dhe normative në punët e kryera financiare. Ai ndikon në avancimin e kontrollit financiar për të ardhmen, pa ndikim në vazhdimësinë e aktiviteteve financiare. Në Kosovë ekziston një rregull përkatës lidhur me kontrollin financiar. Autoriteti suprem i kontrollit financiar, lidhur me fondet dhe paranë publike, është auditori gjeneral. (Arben Dermaku)

KONTROLLI I BARNAVE. Disiplinë e shkencës farmaceutike, që ka për qëllim sigurimin e cilësisë së barnave për përdorim nga popullata. Kjo përmbledh një varg normash teknike, shkencore dhe menaxheriale, që shtrihen në tërë sektorin farmaceutik. Kontrolli i barnave ushtrohet mbi të gjitha preparatet farmaceutike, duke përfshirë edhe vaksinat, serumet, bimët mjekësore, barnat veterinarë etj. Ky aktivitet drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht nga autoriteti për kontroll i preparateve farmaceutike. Procesi mbikëqyret dhe kontrollohet nga Inspektorati Farmaceutik Shtetëror dhe Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM). Inspektorët

kontrollojnë mjediset, kushtet dhe pajisjet ku kryhet fabrikimi i barnave dhe distribuimi, disperzimi dhe prejardhja e barnave për përdorim. AKPPM-ja është themeluar pas vitit 1999 dhe ka laboratorin, departamentin e narkotikëve, departamentin e licencimit të pajisjeve dhe departamentin e farmakovigilencës. Laboratori për produkte dhe pajisje mjekësore filloi punën më 2008. AKPPM-ja mban lidhje me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Përmes departamenteve të saj, sidomos të laboratorit, kryen analizat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të barnave dhe cilësinë e produkteve, duke u bazuar në normativa, standarde dhe legjislacion vendor e ndërkombëtar. Sektori i inspektimit kryen kontroll në farmacitë, depot e barnave, në pikat doganore dhe në fabrikat e prodhimit farmaceutik. Aspektin shkencor dhe profesional të kontrollit e kryen departamenti i farmakovigilencës. (Adnan Bozalija)

KONUSHEFCI Ilir (1969-1998). Veprimtar, njëri nga organizatorët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Llap, Hero i Kosovës. Lindi në fshatin Llugë, komuna e Podujevës. Në maj të vitit 1992, me një grup shokësh themeloi grupin ilegal "Shqiponjat". Në vitin 1993 u përfshi në Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) dhe bënte shpërndarjen e organit të kësaj lëvizjeje "Çlirimi".



ILIR KONUSHEFCI

Në qershor të vitit 1996 ra në kontakt me Z. Pajazitin dhe nga ajo kohë ishte vazhdimisht përkrah tij. Pas rënies së Z. Pajazitit, E. Hoxhës dhe H. Zejnullahut, më 31 janar 1997 kaloi në ilegalitet dhe më pas në Shqipëri, ku punoi për furnizimin me armatim të UÇK-në. Pas vrasjes së Z. Pajazitit, përfaqësoi Zonën Operative të Llapit në Shtabin Qendror të UÇK-së. Më 16 tetor 1997, bashkë me A. Krasniqin, M. Krasniqin dhe Q. Kelmendin organizuan sulmin në stacionin e policisë serbe në Kliqinë të komunës së Pejës. U vra në krye të detyrës në mëngjesin e hershëm të datës 9 maj 1998, në një pritë, derisa udhëtonte për në qytetin e Bajram Currit, në Shqipëri. Presidenti i Republikës së Kosovës e dekoroi me Urdhrin "Hero i Kosovës". (Ismet Cakiqi)

KONUSHEVCI Abdullah (1958-2013). Poet, kritik letrar, përkthyes. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor, gjimnazin dhe Fakultetin Filozofik, degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe



ABDULLAH
KONUSHEVCI

i kreu në Prishtinë. Ndoqi studimet pasuniversitare në fushë të letërsisë krahasimtare në Universitetin e Zagrebit. Ishte gazetar i revistës studentore “Bota e re”, pastaj gazetar shumëvjeçar në rubrikën e kulturës në gazetën “Rilindja”. Nisi

si poet i figurimit të situatave subjektive, simboleve etnike e nacionale dhe komunikimit të verbit letrar me simbolet e shkencave ekzakte, duke vijuar me poetikën e protestës dhe të lutjeve për dashurinë si universalitet. Veprat në poezi të A. Konushevcit janë: “Pasqyrë dhe diell” (1979), “Rënia e mollës” (1981), “Qerija e diellit” (1983), “Loja e strucit” (1987), “Të qenët të mosqenë” (1990), “Pikat AD” (2002), “Dashni dhe vdekje” (2011), “Lutje dashurie” (2012). Për veprën poetike është nderuar me disa çmime. Ndërsa, vepra të kritikës letrare janë studimet për veprën e Adem Demaçit: “Demaçi - Vepra letrare” (2008) dhe “Romani ‘Gjarpitji e gjakut’ i Adem Demaçit” (2011). Gjithashtu ka botuar kritikën letrare në veprën “Për poezinë” (2008) dhe ka përgatitur monografinë “Gjergj Fishta 1871-1940” (2011). A. Konushevci ka botuar një numër recensionesh për letërsinë, pastaj për problemet e onomastikës shqipe si dhe ka hartuar disa tekste shkollore. U shqua për përkthimin nga anglishtja të veprave të literaturës së huaj, nga të cilat veçojmë: “Karakteret” e Teofrastit (1983), “Gintangjali dhe mbledhja e frutave” e Rabindranat Tagorës (1988), “Dielli lind përsëri” i Ernest Heminguejt (1989), “Koncerti dhe tregime të tjera” i Ludo Huperts (2008), “Historia e shqiptarëve të Veriut” të Milan Shufflajit (Shufflayt) (2009). (Nysret Krasniqi)

KONUSHEVCI Arton (1978). Gazetar. Lindi në Llugë të Podujevës. Shkollën filllore dhe të mesme, si dhe studimet për gazetari i përfundoi në Prishtinë. Në fillim punoi gazetar në të përditshmen “Koha ditore”, me pas për dy vjet në “Top Kosova Radio”, gazetar-prezentues i emisioneve politike. Në periudhën 2003-2011 punoi në TV “Kohavision”, fillimisht gazetar

e më pas prezentues dhe redaktor i emisionit të mëngjesit. Më vonë autor dhe redaktor i emisionit “Konfront”, ku janë trajtuar tema të ndryshme politike, sociale dhe kulturore. Nga viti 2007 punon korrespondent i Radios “Evropa e Lirë”. (Besim Abazi)

KONUSHEVCI Valon (1986-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë. Kreu studimet për gazetari dhe komunikim masiv. Gjatë vitit 2006 punoi si gazetar i sportit në të përditshmen “Pavarësia News”. Më pas punoi si gazetar i sportit në gazetën e përditshme “Express”, edhe në formatin elektronik (2008-2013), pastaj në gazetën “Tribuna”, ndërkaq nga viti 2014 redaktor i sportit në gazetën ditore “Zëri”. (Florim Maliqaj)

KONVERTIMI (NDËRRIMI) I FESË ME DHUNË (1912-1914). Ndërrimi i fesë me dhunë i shqiptarëve, pas hyrjes së ushtrisë serbe dhe malazeze në Kosovë në vjeshtë të vitit 1912, që vazhdoi deri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Ishte njëra nga format më të egra të terrorit dhe të gjenocidit për shkombëtarizimin dhe asimilimin e shqiptarëve. Numri i shqiptarëve që u konvertuan me dhunë nën presionin e organeve pushtuese serbe arrinte në disa qindra, ndërsa në territoret e pushtuara nga Mali i Zi reprezaljet me këtë motiv ishin më të egra. Organet e pushtetit malazez vetëm deri në mars të vitit 1913 në rrethin e Pejës konvertuan me dhunë mbi 1.200 shqiptarë myslimanë dhe katolikë. Edhe në Rrethin e Gjakovës u konvertuan rreth 1.200 veta. Në mars të vitit 1913, në burgjet e Malit të Zi për këto shkaqe u gjendën 233 veta, kurse 503 u konvertuan me dhunë. Në viset nën sundimin e Serbisë u konvertuan afër 250 veta, në mesin e të cilëve edhe 98 femra e 7 fëmijë. Konvertime të shumta të fesë pati edhe në Plavë, në Guci, në Rugovë, në Beranë etj. Kështu, deri në maj të vitit 1914 ishin konvertuar në ortodoksë mbi 10.200 shqiptarë myslimanë e katolikë, në mesin e të cilëve edhe një hoxhë dhe një dervish.

Ata që kundërshtonin, zakonisht pushkatoheshin. Ndër ta ishte edhe frati Luigj Pali i Gjakovës, i cili ishte ankuar te konsulli austro-hungarez Pecel për konvertimin me dhunë dhe për rrënimin e 15 xhamive në Gjakovë nga autoritetet malazeze. Ai u pushkatua bashkë me 55 shqiptarë të tjerë në fshatin Janosh të Gjakovës më 22 shkurt 1913. Po kështu,

në shumë fshatra të Strelcit, për shkak të rezistencës, u bënë plaçkitje, u dogjën shtëpi dhe u vranë shumë njerëz. Kundër këtij gjenocidi reagoi ashpër Austro-Hungaria, qeveria e së cilës në mars të vitit 1913 kishte vënë në dijeni edhe qeverinë e Francës për gjenocidin serb dhe malazias ndaj shqiptarëve. Ajo protestoi edhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe kërkoi mbrojtjen e të drejtave fetare e kombëtare të popullit shqiptar. (Fehmi Rexhepi).

KONVIKTET. Institucione për banim, ushqim, mësim dhe aktivitete të lira të nxënësve dhe studentëve. Themelimi i konvikteve lidhet me themelimin e shkollave. Në vitin 1941 themelohet konvikti i shkollës normale “Sami Frashëri” në Prishtinë. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, krahas themelimit të shkollave të mesme (gjimnaze, normale, të mjekësisë, teknike, zejtare, industriale etj.) themelohen edhe konvikte nxënësish në qendra të mëdha dhe të vogla, kryesisht për nxënësit, të cilët ishin me prejardhje nga mjediset larg nga shkolla përkatëse. Në vitin shkollor 1955/56 në Kosovë kishte 23 konvikte të tilla. Ky numër konviktesh shkoi duke u reduktuar dhe përqindja e përfshirjes së nxënësve në to shkoi duke u zvogëluar. Në fillim të viteve 1960 formohen konvikte të përbashkëta nxënësish dhe studentësh në Prishtinë, Pejë, Prizren etj. Në vitin 1980 kishte tetë konvikte nxënësish dhe studentësh në qendrat kryesore të Kosovës, tri prej të cilëve në Prishtinë. Në vitin shkollor 1989/90 në territorin e Kosovës vepronin dymbëdhjetë konvikte për nxënësit dhe studentët. Puna e konvikteve në Kosovë u ndërpre më 1990, kur administrata e dhunshme serbe i përjashtoi të gjithë konviktorët shqiptarë. Konvikti i shkollave të mesme në Prishtinë u shndërrua në stacion të policisë serbe. Pas çlirimit, konviktet e nxënësve të shkollave të mesme nuk e rifilluan punën. Konviktet e nxënësve dhe të studentëve në Pejë, Prizren, Gjiilan etj., u shndërruan në konvikte studentësh. (Hajrullah Koliqi)

KONJUFCA Sherif (1952-). Gazetar. Lindi në fshatin Llugaxhi të Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, pastaj shkollën normale dhe studimet për gazetari në Prishtinë. Në vitet 1980-1984 punoi gazetar në Televizionin e Prishtinës, në programin politik-informativ.

Më pas arrestohet për veprimtari politike, dënohet me 8 vjet burg dhe i ndalohet ushtrimi i profesionit të gazetarit për pesë vjet pas vuajtjes së dënimit. Pas burgut, nga viti 1993 deri më 1999 punoi në redaksinë e lajmeve të Radiotelevizionit Shqiptar (korrespondent nga Prishtina), si dhe redaktor në Radio-Tiranë në emisionin për bashkatdhetarë. Kreu punën e përgjegjës të informimit të disa subjekte politike dhe në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Nga viti 2002 punon në Kuvendin e Kosovës, përgjegjës për medie dhe marrëdhënie me publikun. (Artan Krasniqi)

KONJUSHA Selman (1949-1999). Shkrimtar. Lindi në fshatin Hade të Prishtinës. Mësimet e para i mori në vendlindje, ato të mesme në Prishtinë, ku kreu edhe studimet për ekonomi në Universitetin e Prishtinës. Punoi në vendlindje dhe viteve të fundit në Zvicër. Në periodikun letrar në Prishtinë me krijimet e tij ishte i pranishëm gjatë dy dekadave të fundit të jetës. Shkroi poezi për fëmijë dhe të rritur. Botoi gjashtë libra me poezi, ndër të cilat: “Mundja e harrimit” (1994), “Shitësi i manaferrave” (1995) dhe “Ëndërr e djegur” (1999). (Hasan Hasani)

KOOPERATIVA. Subjekt ekonomik i formuar nga personat fizikë dhe juridikë me qëllim të bashkëveprimit në veprimtarinë ndërmarrëse, përmes aktivitetit të lirë dhe ndarjes së drejtë të rezultateve të prodhimit. Kooperativat bashkëkohore, ndryshe nga kooperativat socialiste, janë një bashkim vullnetar personash për të plotësuar nevojat dhe qëllimet e përbashkëta ekonomike. Qëllim kryesor është realizimi synimeve të përbashkëta biznesore dhe maksimizimi i fitimit. Për anëtarët e vet, kooperativa siguron shërbime më të mira në furnizim, në informim dhe në shitjen e produkteve në treg. Kooperativizmi bujqësor është një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Kooperativizmi evropian është një model suksesi në ekonominë e tregut të lirë, i bazuar në parime demokratike, ku hyrja është vullnetare dhe marrja e vendimeve, organizimi, funksionimi dhe ndarja e fitimeve kryhen në mënyrë transparente. Kooperativat bujqësorë evropianë janë të lidhura ngushtë me mjedisin rural dhe kanë gjeneruar një zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit në aspektet ekonomike, shoqërore, kulturore dhe

mjedisore. Përveç se në bujqësi, kooperativat shtrihen edhe në artizanate, banim, kreditim, sigurim dhe ndërtimtari. Ndonëse janë bërë disa përpjekje të donatorëve për ta nxitur kooperativizmin në disa aktivitete bujqësore në Kosovë, rezultatet deri tani kanë munguar. (Halim Gjergjizi)

KOPAONIKU. Mal, pjesë e masivit të vjetër të maleve Rodope, që kryesisht shtrihen në Serbi. Në Kosovë shtrihet në pjesën verilindore, në drejtimin veriperëndim-juglindje, nga kufiri shtetëror i Kosovës me Serbinë, te maja e Pançiqit (maja më e lartë, 2,017m) e deri te Dumnica e Epërme, përkatësisht lugina e lumit Llap; ndërsa nga luginat e poshtme të Ibrit dhe Sitnicës në perëndim, deri te fushëgropa e Llapit në lindje. Nga 100 km të gjatësisë së tij, 40 km janë në Kosovë. Morfologjia e Kopaonikut është para së gjithash rezultat i lëkundjeve të fuqishme tektonike të kohës së terciarit të vonë, kur ndodhi edhe thyerja, çarja dhe lëshimi e masës kontinentale të vjetër të Rodopeve dhe krijimi i maleve, kodrave dhe kodrinave në të shumtën në formë të pllajave, nga të cilat ngrihen maje të vetmuara malore, nga të ndara në mes veti me lugina të thella të krijuara nga veprimi i fuqishëm eroziv vertikal i lumenjve (lumi i Ceraja, Bistrica e Shalës, lumi i Trepçës, i Kaçanollit, i Qytezës, i Sllakofcit etj.), përrrenjve dhe përroskave, degë të lumit Ibër, të cilat karakterizohen me fuqi të madhe erozive. Luginat e lumenjve kryesisht kanë shpate me pjerrtësi të butë, në disa pjesë në formë kanioni, ku dominojnë forma të buta relievore të maleve dhe kodrave, të mbuluara me livadhe, kullota dhe pyje. Kopaoniku në përgjithësi është zonë me lartësi mesatare rreth 1,100 m, ndonëse shumë maja kanë lartësi nga 1,500-1,985 m. Malet më të dalluara janë: mali Bajrak (1,789 m), Shatorica (1,750 m), Maja e Madhe (1,755 m), Bareli (1,583 m), Kodra e Lartë (1,558 m) etj. Në ndërtimin gjeologjik pjesën më të madhe e përbëjnë formacione të shkëmbinjve të vjetër të paleozoit dhe mesozoit (gëlqerorët, rreshpet, serpentinitet etj.). Thyerjet tektonike të terciarit dhe aktiviteti vullkanik kanë kushtëzuar krijimin e shkëmbinjve magmatikë, të cilët janë bartësit kryesorë të xeheve të metaleve të plumbit, zinkut, argjendit, arit etj., eksploatimi i të cilëve kishte nisur që në kohën antike. Për shkak të pasurisë së argjendit, romakët e quanin “Monte Argentarum”, ndërsa turqit “Gümüş Dağı”

(Male të Argjenda), ndërkaq në shumë harta të mesjetës është shënuar me emrin “Albanus Mons” dhe “Mons Albanus”. Falë resurseve në minerale, Kopaoniku, në veçanti Trepça e Shalës së Bajgorës pas Luftës së Dytë Botërore u bë njëra nga qendrat më të mëdha metalurgjike të plumbit dhe të zinkut në Europë, duke u shndërruar në bartësen kryesore të zhvillimit industrial dhe ekonomik të Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë. (Bektesh Vidishiçi)

KOPERNICA Sylë (1908-1987). Veprimtar i çështjes kombëtare. Lindi në Kopernicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Hogosht. Gjatë shërbimit ushtarak në Dibër (1929), ik në Shqipëri, prej nga kthehet një vit më vonë. Më 1935 bie në kontakt me Haqif Tetovën dhe Ferhat Dragën. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, më 1941 emërohet postëkomandant i policisë në komunën e Hogoshtit. Në vitin 1942, me fillimin e organizimit vullnetar për mbrojtjen e kufirit nga sulmet serbe caktohet komandant i vullnetarëve për komunën e Hogoshtit. Në vitin 1943 zgjidhet komandant i batalionit për mbrojtjen e kufirit nga Novaka deri në Kopilaçë. Në pranverë të vitit 1944 udhëhoqi me formacionet ushtarake të ashtuquajtura “Fuqitë kreshnike”, që u vendosën në komunën e Hogoshtit. Mori pjesë në luftërat e Kikës dhe në beteja të tjera. Në nëntor të vitit 1944 hyn në Brigadën III Nacionalçlirimtare të Kosovës. Shërbeu në Pejë dhe në Prishtinë deri në qershor të vitit 1945, kur demobilizohet për shkak të moshës. U përfshi në aktivitetin e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare dhe u burgos më 1946, por u lirua për mungesë provash. (Naim Musliu)

KOPILIQI Milosh. Hero legjendar i Betejës së Kosovës (1389), i shfaqur në burime tregimtare dhe në këngët epike popullore serbe dhe shqiptare vetëm nga fundi i shek. XV, për të identifikuar “luftëtarin fisnik”, i cili kishte vlarë sulltan Muratin I. Edhe për vrasjen e Muratit I, edhe për vrasësin e tij, Milosh Kopiliqin, shumë gjëra kanë mbetur të paqarta, meqë mungojnë burimet relevante. Ndërkaq, kulti i Milosh Kopiliqit u shfaq vetëm në shek. XIX, kur ai u njoh zyrtarisht nga kisha serbe si “hero i Kosovës” dhe kur portreti tij u shfaq në freskat e kishave.

Burimet historike hedhin dritë më tepër për aspekte onomastike sesa për personalitetin

historik të Kopiliqit. Fshati Kopiliq i Drenicës përmendet në regjistrin osman të vitit 1455 (Kopiliqi i Epërm dhe Kopiliqi i Poshtëm). Dokumenti i vetëm zyrtar i kohës, letra e komunës së Firencës (20. 10. 1389), për vrasës të sulltanit i konsideronte dymbëdhjetë bujarët, që ishin betuar për ta kryer vrasjen. Historianët e shek. XV, në anën tjetër, edhe pse e përmendin betejën, nuk e përmendin fare emrin e vrasësit të sulltanit, ose vetëm e përmendin pjesërisht. Kështu, K. Filozof, biograf i despotit serb St. Lazareviq nuk përmend as emrin e sulltanit, as të vrasësit të tij (rreth vitit 1431). Halkokondili, rreth vitit 1463, e zë në gojë vetëm emrin *Miloes*. Nga fundi shek. XV, burimet tregimtare dhe letrare do ta përmendin emrin e plotë të Milosh Kopiliqit. Emri i tij i plotë (*Biliş/Beleş Küb-ila*) zë fill së pari te kronisti osman, Ashik Pashazade (1484). Kjo trajtë osmane pas një shekulli u përhap edhe në traditën serbe, arbërore, italiane, gjermane etj. Trajtën e italianizuar (*Milos Cobilichio*) e bën të ditur përkthyesi anonim i Dukas-it (fundit i shek. XV). Po kështu si *Milosso Cobilichio* e shënon M. Beçikemi (1504), M. Orbini (1601) etj. Trajtën sllave *Miloš Kobila* e gjejmë te “Kronika e Jeniçerit” rreth vitit 1497. Këto burime bëjnë të ditur se shndërrimi i mbiemrit Kopiliq-Kobiliq në Obiliq është bërë nga historiani P. Julinac (1765) dhe folkloristi V. Karaxhiq (1818). Studiuesit F. Miklosiç dhe P. Skok janë të mendimit se emri Kopiliq është huazim nga gjuha shqipe. (Jahja Drançolli)

KOPITAR Jernej (1788-1844). Filolog sloven, jurist. U diplomua në liceun e Lubjanës. Punoi si administrator në Bibliotekën e Gjykatës së Vjenës, si shef censor (kryesor) për librat e shkruara në gjuhët sllave dhe në gjuhën moderne greke. J. Kopitar botoi gramatikën e parë në gjuhën sllave më 1808 “Gramatikë e gjuhës së sllavëve në Krain, Karnten dhe Steyemark” (Gramatik der Sprache Slavischen in Krain, Karnten und Steyemark). Është i njohur për rolin që luajti në mbështetje të reformës për gjuhën serbe, duke përkrahur idetë e Vuk Karaxhiqit. Kopitar dha një kontribut të rëndësishëm në fushë të ballkanistikës. Ai, duke marrë në vështrim rumanishten, bullgarishten dhe shqipen, erdhi në përfundim se ekziston një “Union gjuhësor ballkanik” që e përbëjnë elementet e përbashkëta të shqipes, rumanishtes dhe bullgarishtes. (Bahri Koskoviku)

KOPRIVA Shaban (shek. XX). Veprimtar i lëvizjes kombëtare. U dallua në rezistencën kundër zgjedhës osmane gjatë viteve 1900-1902. Ishte përkrahës dhe pjesëmarrës i të gjitha aktiviteteve kryengritëse në luftë për çlirim nga Perandoria Osmane. Në tetor të vitit 1902, me ndërhyrjen e ushtrisë osmane në Drenicë, organet e ndjekjes akuzuan Sh. Koprivën si njërin nga organizatorët e aktiviteteve antiosmane. Edhe në vitet e mëvonshme dha kontribut për organizimin e kryengritjeve kundër ushtrisë osmane në rajonin e Mitrovicës. Në mbledhjen e këshillit konsultativ për kryengritje antiosmane të mbajtur në vitin 1909, që u mbajt në një fshat afër Shkupit, morën pjesë figura të shquara të lëvizjes kombëtare të vilajetit të Kosovës, në mesin e të cilëve ishte edhe Sh. Kopriva. Ai përfaqësonte kracinën e Drenicës. (Luan Tetaj)

KORDINJANO Fulvio (Cordignano) (1887-1952). Albanolog italian, prift jezuit. Në Kremona studioi letërsi dhe filozofi. Në vitet 1912-1916 dha mësim në Kolegjin Saverian në Shkodër, ndërsa në periudhën 1917-20 i plotësoi studimet për teologji në institucionet katolike dhe vijoi veprimtarinë në Angli, Irlandë e Belgjikë. Më 1924 u kthye në Shkodër, ku dha mësim filozofie dhe letërsie. Nga 1926-1941 kreu misionet fetare në Shqipërinë e Veriut. Për pikëpamjet që u konsideruan fyese në një artikull të tij për shqiptarët më 1941, jezuitët e larguan nga Shqipëria. Botoi disa gramatika e fjalorë, si: “Gjuha shqipe (dialekti gegë): Gramatikë, ese letrare, frazeologji dhe fjalë të urta” (Lingua Albanese (dialeto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi, 1931); “Fjalor shqip-italisht dhe italisht-shqip” (Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese, 1934 dhe 1938) etj. Vepra të tjera të tij janë: “Epojeja kombëtare e popullit shqiptar” (1925); “Shqipëria përmes punës dhe shkrimeve të një misionari të madh italian, Fr Domenico Pasi S.J. 1847-1914” (L’Albania attraverso l’opera e gli scritti di un grande missionario italiano, il P. Domenico Pasi S.J. 1847-1914, në tri vëllime, me 1,300 faqe, me Z. Valentinin, botuar më 1933-1934); “Vasha nëpopen kombtare të popullit shqiptar: Tringa e Malcis” (1939); “Poezia epike e zonave kufitare të Shqipërisë së Veriut” (La poesia epica di confine nell’Albania del Nord, 1-2, 1943) etj. (Shpëtim Elezi)

KORENICA Agim (1942-2011). Inxhinier i metalurgjisë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Mitrovicë, studimet e rregullta dhe të magjistraturës i kreu në Universitetin e Beogradit. Punën e inxhinierit të metalurgjisë e filloi në Fabrikën e Akumulatorëve të “Trepçës” në Mitrovicë, ku udhëhoqi repartin e baterive të akumulatorëve të plumbit. Më pas kaloi me punë në metalurgjinë e plumbit, në detyrën e drejtorit teknik. Në këtë periudhë (1980-1985) në metalurgji u arrit prodhim rekord dhe cilësor i plumbit të rafinuar dhe i metaleve të tjera, si bismut, ar dhe argjend. Ne procesin mësimor në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Metalurgjisë ishte i angazhuar fillimisht si ligjërues e më pas profesor për disa lëndë në seksionin e metalurgjisë. U specializua në fushën e metalurgjisë së plumbit, duke qëndruar për një kohë në kompaninë e njohur franceze “Penarroya Noyelles Godault” dhe në vende të tjera të Europës. (Avni Terziqi)

KORETINI. Fshat i tipit të dendur me formë të zgjatur, rreth 4 km në jug të Kamenicës. Shtrihet në dy anët e lumit Krivareka dhe përgjatë rrugës Kamenicë-Gjilan. Përmendet në disa dokumente të shkruara. Pas okupimit nga Serbia (1912) mbi 30 familje shqiptare migruan në Turqi. Nga viti 1924 në Koretin fillojnë të vendosen kolonë serbë. Deri në vitin 1937 u vendosën 68 familje kolone me 348 banorë. Në vitin 1948 kishte 1,309 banorë, ndërsa tani (2011) ka 3,478 banorë. Veprimtari kryesore ekonomike është bujqësia. Banorët e fshatit njihen për kultivimin e fidanëve dhe të bimëve dekorative. Ka disa njësi tregtare dhe zeytari për përpunimin e drurit. Nga objektet e standardit shoqëror ka shkollën 9-vjeçare, qendrën e mjekësisë familjare etj. (Muhamed Kallaba)

KORI I BURRAVE TË GJAKOVËS. U themelua në vitin 1965 nga kompozitori Rauf Dhomi. Me të përfunduar Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, R. Dhomi mblodhi disa burra profesionesh të ndryshme, por me prirje këndimi e ndjesi muzikore. Fillimisht ishin tetë anëtarë, më pas u bënë 12 dhe 16 veta. Kështu grupi “a capella” i bëri hapat e parë, bënte prova në shtëpinë e vogël përdhese pas Normales së vjetër të qytetit. Hapi i parë i këtij Ansambli koral u zhvillua mbi bazën e një tradite të pasur muzikore e kulturore të qytetit të Gjakovës. Në vitin 2015, Kori i Burrave të Gjakovës shënoi 50-vjetorin e themelimit. (Krenar Doli)

KORI PROFESIONAL I RTP-SË. U themelua më 1980, për përmbushjen e nevojave programore, incizimeve të veprave korale, vokalo-instrumentale të kompozitorëve tanë dhe



KORI PROFESIONAL I RTP-SË

të huaj. Në Radio-Prishtinë në vitet ‘50, me Orkestrën simfonike vepronte Kori i Radios për incizimin e këngëve të përpunuara dhe të kompozuar korale. Me Orkestrën e Radios realizoheshin herë-herë koncerte veprash vokalo-instrumentale (R. Mulliqi, Kantata “Poema për ata”). Kori profesional iu besua kompozitorit dhe dirigjentit Rafet Rudi dhe përmbushi nevojat e programit të Radiotelevizionit të Prishtinës për shtatë sezona me vepra korale e vokalo-instrumentale të autorëve vendorë dhe të huaj, realizoi koncerte me vepra periudhash të ndryshme stilistike e bashkëkohore dhe mori pjesë në festivale vendore e ndërkombëtare. Për disa vjet korin e ka udhëhequr dhe kompozitori Baki Jashari, deri në fillim të viteve ‘90, kur u ndërpre dhunshëm puna e tij për shkak të rrënimit të institucioneve të Kosovës nga Serbia. (Zeqirja Ballata)

KORITNIKU. Mal në pjesën jugperëndim të Kosovës, në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri, që zbret në veri deri te lugina e Drinit të Bardhë, kurse në jug, juglindje dhe jugperëndim kufizohet me lumin e Plavës (Lumës). Shtrihet deri në lartësinë mbidetare 2,395 m. Përbëhet kryesisht nga shkëmbinj të gëlqerorë të rikristalizuar të moshës së triasikut. Në aspektin gjeomorfologjik hasen forma karstike të ndryshme, si dhe forma akullnajore (cirqe, lugina akullnajore, morena). Karakterizohet me klimë të ftohtë malore, me temperatura mesatare vjetore mes 2-6°C dhe reshje deri në 1,200 mm. Në aspektin hidrologjik paraqet

ujëndarësin në mes Drinit të Bardhë dhe lumit të Plavës. Nga rrëzat e Koritnikut burojnë disa degë të lumit të Plavës. Lloji më i përhapur i bimësisë është dushku, ahu, pisha etj. (Valbon Bytyçi)

KORKUTI Muzafer (1936-), Arkeolog. Lindi në Fterrë të Sarandës. Pasi kreu shkollën fillore në fshatin e lindjes, ndoqi mësimet në shkollën shtatëvjeçare dhe të mesme në Shkodër



MUZAFER
KORKUTI

dhe studimet në degën e Historisë të Universitetit të Tiranës (1962). Për një kohë të shkurtër ndoqi studimet në Leningrad (Shën Petërburg), të cilat i ndërpreu për shkak të prishjes së marrëdhënieve midis dy vendeve. Kreu specializimin për arkeologji në Kinë. Punoi si mësues dhe drejtor i shkollës shtatëvjeçare të Kuçit (1954-1957) dhe pastaj në Qendrën e Studimeve Arkeologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. U specializua në fushën e parahistorisë dhe drejtoi gërmime në më shumë se 15 qendra parahistorike. Botoi artikuj shkencorë në revista shkencore në Shqipëri dhe jashtë. Është bashkautor i teksteve universitare "Arkeologjia" (1972, 1993), "Historia e Shqipërisë", "Les Illyriens" (1985), "Historia e popullit shqiptar" (2003), "Harta Arkeologjike e Kosovës I" dhe autor edhe i "Neolithicum und Chalkolithicum in Albanien" (1995). Ishte ligjërues i arkeologjisë në Universitetin e Tiranës (1968-2002) dhe në atë të Prishtinës (1972-1975). Ligjëroi në universitete të ndryshme: Paris (Francë), Heidelberg dhe Munster (Gjermani), Romë, Pizë, Bari, Leçe e Bolonjë (Itali), Athinë e Selanik (Greqi), Vienë (Austri), Sinsinati (SHBA) etj. dhe mori pjesë në shumë simpoziume dhe kongrese ndërkombëtare. Ishte drejtor i Institutit të Arkeologjisë (1982-1992; 1998-2006), kryeredaktor i revistës "Iliria" (1971-1975, 1986-1991, 1998-2002), zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2009-2010) dhe kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2014-). Bashkëdrejtoi projektin me universitetin e Teksasit (SHBA) në Konsipojë (1991-1996). Është anëtar i Komitetit të Përhershëm të Shkencave Parahistorike Botërore (1986) dhe anëtar korrespondent i Institutit Gjerman të Arkeologjisë

(1986). U dekorua në Shqipëri me Urdhrin "Mjeshtër i Madh" (2006) dhe dekoratën "Nderi i Kombit" (2015). (Pleurat Kabashi)

KORNIZA E KURIKULËS SË RE TË KOSOVËS (KKK). Dokument themelor i reformës së arsimit parauniversitar në Kosovë, i hartuar në vitin 2001, nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë. Në bazë të tij ka filluar të zbatohet struktura e re e arsimit parauniversitar në Kosovë (5+4+3), janë hartuar planet dhe programet mësimore për klasën I deri në klasën XII/XIII, janë zhvilluar vlerësimet e jashtme të nxënësve në klasat V, IX dhe XII/XIII dhe janë hartuar dhe implementuar programe të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimeve. Në vitin 2008 filloi procesi i rishikimit të pjesshëm të këtij dokumenti, me qëllim të harmonizimit të tij me zhvillimet në arsim pas vitit 2001. Kjo rezultoi me miratimin e dokumentit të ri: Korniza e kurikulës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011), e cila bazohet në kompetenca dhe në rezultate mësimore. Është e strukturuar në shtatë fusha kurrikulare, të cilat zhvillohen përgjatë gjithë arsimit parauniversitar. Në bazë të KKK-së janë hartuar kurrikulat bërthamë për tri nivelet e arsimit parauniversitar. Në shtator të vitit 2013 filloi pilotimi i tyre. (Selim Mehmeti)

KORNIZA KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJEN E PËRKOHSHME NË KOSOVË (2001). Akti më i lartë juridik në Kosovë në periudhën 2001-2008. Korniza Kushtetuese ishte rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, me të cilën rregullohej juridikisht organizimi institucional dhe funksionimi i Kosovës në periudhën e protektoratit ndërkombëtar para shpalljes së pavarësisë. Për nga forma ishte rregullore e UNMIK-ut (e bazuar mbi Rezolutën 1244/99 të KS të OKB-së), ndërkaq për nga përmbajtja paraqiste aktin më të lartë kushtetues të Kosovës nën administrimin ndërkombëtar. Në mungesë të Kushtetutës së Kosovës, ishte një parakushtetutë, që rregullonte qeverisjen e Kosovës, duke përcaktuar organizimin e pushtetit, institucionet e përkohshme vetëqeverisëse, kompetencat e tyre, marrëdhëniet e tyre me UNMIK-un dhe KFOR-in etj. Dispozitat themelore të Kornizës Kushtetuese e përcaktonin Kosovën si: "një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, që me pullin e vet ka attribute unike, historike,

juridike, kulturore dhe gjuhësore”. Institucionet më të larta ishin: Kuvendi, kryetari i Kosovës, Qeveria, gjykatat dhe institucionet e tjera të pavarura”. Korniza përcaktonte tri kategori kompetencash: kompetencat e pastra të institucioneve të Kosovës; kompetencat e përziera të institucioneve të Kosovës dhe të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të UNMIK-ut dhe kompetencat ekskluzive të PSSP-së, të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Sipas Kornizës Kushtetuese, kompetencat më të larta vendimmarrëse dhe përfundimtare ishin ato të PSSP-së, si autoriteti më i lartë në Kosovën e administruar nga bashkësia ndërkombëtare.

Kornizën Kushtetuese e hartuan një grup ekspertësh juridikë vendorë dhe ndërkombëtarë. Nga drafti final, që ishte aprovuar nga departamenti Juridik i OKB-së në Nju-Jork, ishin hequr elementet e shtetësisë së Kosovës, siç ishin: vazhdimësia kushtetuese dhe politike e Kosovës, simbolet kombëtare, e drejta për referendum të popullit të Kosovës në lidhje me statusin final etj. Korniza Kushtetuese u aprovua në OKB, në Nju-Jork dhe u nënshkrua nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Hans Hakerup, më 15 maj 2001. Në periudhën 2001-2008 Korniza Kushtetuese mbeti akti më i lartë juridik në Kosovë, deri në shpalljen e pavarësisë. Modeli i Kornizës Kushtetuese të Kosovës, si akti më i lartë juridik i territoreve nën administrimin e OKB-së, u shfrytëzua edhe në administrimet e tjera ndërkombëtare. (Blerim Reka).

KORONICA Ahmet (-1879). Njeri nga themeluesit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP). Lindi në Gjakovë, ku një kohë shërbeu si kadi i kazasë. Mbante kontakte të fshehta me përfaqësuesit anglezë, që propagandonin në Kosovë në favor të shtetit të tyre (1877). Ishte anëtar i Komitetit të Stambollit, i cili e dërgoi, së bashku me Haxhi Ymer Prizrenin, për të themeluar LSHP-në. Ai me patriotët e tjerë, të ftuar në Stamboll nga sulltani, që dëshironte ta pengonte formimin e LSHP-së, u nisën për në Prizren më 8 qershor 1878. Në Kuvendin themelues të LSHP-së u dallua në luftë kundër krahut sulltanist. Mbronte platformën e Komitetit të Stambollit për autonominë e Shqipërisë. Me Sylejman Vokshin themeluan degën e LSHP-së në Gjakovë. E kundërshtoi ashpër dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë Malit të Zi në bisedimet me Mehmet Ali Pashën

(në Prizren dhe në Gjakovë). Në Gjakovë ishte ndër organizatorët kryesor të vrasjes së mareshalit osman. Pas përçarjeve që shkaktoi kjo vrasje, A. Koronica dhe Ali Pashë Gucia formuan Lidhjen e Re në Gjakovë dhe kërkuan nga degët e tjera të Kosovës dhe të Dibrës të bashkoheshin me Gjakovën. Por Lidhja e Re nuk hasi në përkrahje të platformës së saj luftarake dhe prandaj u shua. Ndonëse kadiu i Gjakovës e vazhdoi edhe më tutje veprimtarinë e tij patriotike në kuadër të LSHP-së, nuk ishte në elitën politike të saj. Në janar 1879 u emërua kadi në Manastir, ku së shpejti u nda nga jeta. (Masar Rizvanolli)

KORONICA Bashkim (1938-2016). Vreshtar, profesor universiteti. Lindi në Gjakovë, shkollën fillor dhe të mesme i kreu në vendlindje, studioi për pemëtari dhe vreshtari në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Sarajevës. Kreu edhe specializimin nga lëmi i vreshtarisë në Francë (1967). Studimet pasuniversitare i vazhdoi në Fakultetin e Shkencave Bujqësore të Universitetit të Zagrebit, ndërsa tezën e disertacionit nga fusha e vreshtarisë e mbrojti në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1998). Punoi teknolog në kombinatin bujqësor industrial “Ereniku” në Gjakovë dhe u mor me ngritjen e plantacioneve të reja të vreshtave. Më vonë kalon me punë në Sekretariatit Krahinor për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave (1975) dhe zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës (1976). Publikoi punime shkencore dhe profesionale si dhe ka botoi libra nga lëmi i vreshtarisë (“Vreshtaria”, “Verëtaria”). (Agim Zajmi)

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS (KEK). Kompani publike që ka në pronësi dhe operon me asetet prodhuese (gjeneruese) të energjisë elektrike në Kosovë. KEK-u u themelua në vitin 1999, si kompani e integruar vertikalisht dhe pasuese e drejtpërdrejtë e Elektroekonomisë së dikurshme të Kosovës. Pas procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë, në KEK kanë mbetur aktivitetet e prodhimit të linjtit dhe të energjisë elektrike nga qymyri. Kapacitetet kryesore të prodhimit janë termocentralet (TC) “Kosova A” (1960-1975) me pesë njësi prodhuese, me fuqi prej 800 MW dhe “Kosova B” (1983-1984) me dy njësi prodhuese dhe fuqi prej 678 MW. Termocentralet janë të



MIHJA SIPËRFAQËSORE E KEK-ut

vendosura në Obiliq, në afërsi të minierave të linjtit. Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit, që shtrihen në basenin e Kosovës, të Dukagjinit dhe në fushën e Skënderajt, që vlerësohen të jenë rreth 14 miliardë tonë. Shfrytëzimi i linjtit në basenin e Kosovës ka filluar në vitin 1922, me gërmim nëntokësor në kufirin lindor të minierës së Mirashit dhe është përmbyllur në vitin 1965. Në vitin 1962 është hapur miniera e Mirashit, me mihje sipërfaqësore për të furnizuar gjeneratorin e parë të TC “Kosova A” me fuqi 65 MW. Zgjerimi i minierave në Mirash (1984) me kapacitet 8,4 milionë tonë në vit, në Bardh (1986) me kapacitet 8,6 milionë tonë në vit, në Sibofcin jugperëndimor (2010) me kapacitet 9 milionë tonë në vit, i ka paraprirë zgjerimit të njërive gjeneruese të TC “Kosova A” dhe “Kosova B”, të Tertores dhe të Gazifikimit, për të vazhduar me furnizimin e TC “Kosova e Re”, e cila është planifikuar të ndërtohet afër TC “Kosova B”, me fuqi prej 600 MW. TC “Kosova e Re” nuk parashihet të jetë në kuadër të KEK-ut. Kapacitetet aktuale të njërive gjeneruese janë dukshëm më të ulëta se ato nominale për shkak të vjetërsisë së stabilimenteve. Njësitë A1 dhe A2 janë jashtë prodhimit që nga viti 1999. Njësitë e tjera (tri të “Kosova A”-së dhe dy të “Kosova B”-së), pas riparimeve të rëndomta dhe kapitale, japin fuqinë prej 875 MW. Këto TC në vitin 2013 kanë prodhuar 5,700 GWh energji elektrike, që është 97% e energjisë së prodhuar, ndërkaq sasia prej vetëm 3% është prodhuar nga hidrocentralet. KEK-u është i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE-ja) për prodhim të energjisë elektrike. ZRRE-ja rregullon aktivitetet e KEK-ut dhe përcakton të hyrat maksimale të lejuara për të mbuluar kostot e prodhimit të energjisë, që paraqesin elementin kryesor të formimit

të tarifave për konsumatorët fundorë. E gjithë energjia e prodhuar i shitet me çmime të rregulluara Korporatës për Furnizim, KESCO, e cila përmes Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (KOSTT-it) dhe rrjetit të shpërndarjes së KEDS-it, e dërgon te konsumatorët fundorë. Në periudha të caktuara, kur KESCO-ja nuk mund ta marrë gjithë sasinë e energjisë së prodhuar, KEK-u mund t’i plasojë tepricat me çmime të kontraktuara në tregun e energjisë. Meqë prodhimi vendor në periudha të caktuara nuk e mbulon konsumin e energjisë, KESCO-ja, përmes tenderëve të hapur, importon energjinë e nevojshme për konsumatorë. (Justina Shiroka-Pula)

KORPORATA. Një person juridik që ushtron aktivitet afarist me personalitet ligjor të ndarë dhe të veçantë nga pronarët e vet dhe që ka zotësinë juridike për të vepruar, për të lidhur kontrata, për të mbajtur në pronësi pasuri dhe për të paditur. Ligji në fuqi në Kosovë përcakton se një korporatë mund të organizohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo si një shoqëri aksionare. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është formë e organizimit që në Kosovë zakonisht hasen te korporatat që kanë më pak pronarë, pasi forma e organizimit të veprimtarisë dhe e qeverisjes është më e thjeshtë. Ligji në fuqi në Kosovë përcakton se interesat pronësore janë njësitë pronësore në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe, si të tilla, mund, por nuk është e domosdoshme të evidentohen me certifikata të pronësisë dhe mund të referohen si aksione. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është përgjegjëse për detyrimet ndaj palëve të treta, me gjithë pasurinë e saj. Rrjedhimisht, sipas ligjit, në Kosovë pronarët nuk janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar vetëm për arsyen se janë pronarë. Për themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar nuk nevojitet kapitali themeltar. Sipas ligjit shoqëria aksionare paraqet një preson juridik me personalitet të veçantë juridik, të ndarë dhe të dallueshëm nga pronarët e vet. Për dallim nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, shoqëria aksionare ka një strukturë më të përbërë qeverisëse e cila përfshin, mes tjerash, kryeshëfin ekzekutiv, bordin e drejtorëve dhe kuvendin e aksionarëve. Kapitali themeltar për regjistrimin e një shoqërie aksionare në Kosovë është 10,000 euro. Edhe pse një shoqëri

aksionare mund të ketë vetëm një pronar, kjo strukturë e organizimit ligjor të një korporate ka për qëllim të sigurojë një qeverisje efikase në një korporatë me shumë pronarë. (Dastid Pallaska)

KOSMAÇI. Mal në Kosovën Qendrore, i lartë 976 m, shtrihet në pjesën perëndimore të rajonit të Drenicës. Nga ana lindore lëshohet gradualisht në drejtim të vendbanimit Krajkovë, në veri vazhdon deri në vendbanimin Baincë në një gjatësi rreth 6 km, ndërsa nga ana perëndimore dhe jugperëndimore lëshohet në drejtim të vendbanimit Vuçak dhe Negroc, kurse në jug deri te gryka e Llapushnikut. Kryesisht ndërtohet nga formacionet e fllshit të kretakut, diabaz-strallorët etj. Është diferencuar në formë të një blloku malor, nga lëvizjet tektonike vertikale, ndaj fushëgropës së Drenicës. Karakterizohet me bimësi të zhvilluar, kryesisht me dushk. (Shpejtim Bulliqi)

KOSOVA GJATË SUNDIMIT OSMAN. Pushtimi osman i Kosovës së sotme ka filluar në kohën e sundimit të Muratit I (1359-1389) dhe është përmbyllur në kohën e sulltan Mehmetit II (1451-1481). Këtyre pushtimeve u hapi rrugën fitorja osmane në Betejën e Maricës (1371), pas së cilës viset e Rrafshit të Dukagjinit me Prizrenin dhe Pejën, deri pranë Novobërdës, hynë nën sundimin e Balshajve. Pas vrasjes së Balshës II në Betejën e Savrës (1385), një pjesë e Kosovës Jugperëndimore kaluan në zotërim të Dukagjinasve, të cilët lidhën marrëveshje vasaliteti me sulltanin. Në vitin 1388 një forcë e akinxhinjve osmanë ndërmori inkursionin e parë të rëndësishëm në Kosovë, si përgjigje hakmarrëse e Muratit I ndaj goditjes së rëndë që pësoi në Plloçnik (1387) dhe në Bileqë (1388). Ky inkursion i hapi rrugë Betejës së Kosovës në qershor të vitit 1389. Pas ngadhënjimit në këtë betejë dhe konsolidimit të pushtetit të tyre në Shkup (1392), osmanët futën nën kontroll pothuaj tërë Kosovën. Në vitin 1448 Kosova përsëri u bë arenë lufte midis ushtrisë hungareze të prirë nga Huniadi dhe ushtrisë osmane të sulltan Muratit II (1421-1451). Edhe kjo betejë rezultoi me fitoren e forcave osmane, duke e vulosur përfundimisht fatin e Kosovës në pesë shekujt vijues. Pas një rrethimi 40 ditësh, në qershor të vitit 1455 Novobërda, qyteti më i madh dhe më i pasur i Kosovës iu dorëzua

forcave të sulltan Mehmetit II. Të njëjtin muaj u pushtua përfundimisht edhe Prizreni, pas katër pushtimeve të përkohshme (1382, 1389, 1410 dhe 1425). Kosova tërësisht ra nën pushtetin osman në vitin 1462, kur Peja u pushtua nga sulltan Mehmeti II. Gjatë periudhës 80-vjeçare, nga pushtimi i parë i Prizrenit (1382) e deri në pushtimin e Pejës (1462), vise të ndryshme të Kosovës kanë njohur disa herë pushtime e ripushtime osmane.

Pushteti osman në Kosovë solli ndryshime në jetën politike, ekonomike, shoqërore, administrative, fetare dhe kulturore. Fill pas pushtimit nisi zbatimi i sistemit të timarit, i cili mbështetej në pronësinë feudale ushtarake mbi tokën. Tokat e punueshme konsideroheshin prona shtetërore. E drejta e shfrytëzimit të tokës legjitime hej me tapi. Çdo shfrytëzues i tokës, me tapinë pranonte edhe detyrimin e një të dhjetës të prodhimeve të tokës ndaj shtetit, ndërsa shteti këtë detyrim ua lejonte pushtetarëve feudalë që ta merrnin si pagë vjetore. Shumica dërrmuese e pushtetarëve ushtarakë dhe civilë në Kosovë ishin shqiptarë të konvertuar në islam, por kishte edhe një numër spahinjsh shqiptarë të krishterë. Territori i Kosovës i ka takuar san-xhaqeve të Vuçitërnës, Prizrenit, Dukagjinit dhe pjesërisht sanxhaqeve të Shkupit dhe të Shkodrës. Secila nga këto njësi administrative drejtoheshin nga sanxhakbeu përkatës dhe të gjitha vareshin nga bejlerbeu i Rumelisë. Njësitë administrative më të vogla se sanxhaqet ishin nahijet. Në qendrat e sanxhaqeve u themeluan gjykatat që drejtoheshin nga kadinjtë. Gjykatat funksiononin në bazë të ligjit islamik, sheriatit. Përveç te sheriatit, gjykatat mbështeteshin edhe në legjislationin shtetëror osman, ku bënin pjesë kanunnametë, dekretet sulltanore (fermanet, beratet), pastaj urdhëresat e sadriazemit dhe të bejlerbeut të Rumelisë.

Pas instalimit të administrimit osman në Kosovë, filloi edhe procesi i islamizimit të popullsisë shqiptare. Fenë islame fillimisht e përqafoi aristokracia shqiptare, gjë që ia mundësoi t'i ruante privilegjet dhe të inkuadrohej në strukturat e larta drejtuese të Perandorisë. Në gjysmën e dytë të shek. XVI u islamizua rreth gjysma e popullsisë shqiptare nëpër qytete, kurse në shek. XVII feja islame mbizotëronte edhe në fshatra. Fundi i shekullit XVII e gjeti popullatën e Kosovës me mbi dy të tretat e saj me përkatësi fetare islame. Procesit i kalimit në

islam ua hapi rrugën shqiptarëve që të integroshin në jetën shoqërore të Perandorisë Osmane, duke ua mundësuar atyre të merrnin rol të rëndësishëm në shtresën drejtuese të kësaj perandorie, në ushtri, administratë dhe në shërbime të tjera shtetërore.

Disfata e madhe që pësuan osmanët para mureve të Vjenës më 1683, shënoi kthesë në rrjedhat historike të Perandorisë Osmane dhe të Kosovës si pjesë e saj. Nga mesi i tetorit të vitit 1689 Kosova u përfshi në luftërat shkatërrimtare habsburge-osmane. Këto luftëra, bashkë me epideminë e murtajes, morën shumë jetë njerëzish dhe shkatërruan shumë të mira materiale dhe kulturore. Nga fillimi i shek. XVIII disa dyer të mëdha të fisnikërisë shqiptare të Kosovës, si: Mahmutbegollajt e Pejës, Kurtpashajt (ose Kryezitë) e Gjakovës, Rrotllajt e Prizrenit dhe Gjinollajt e Prishtinës e Gjilanit filluan të ushtronin pushtet pothuaj autonom në njësi të ndryshme administrative brenda Kosovës dhe më gjerë. Ky zhvillim vazhdoi deri në kohën e Tanzimatit, kur si pasojë e rezistencës kundër centralizimit të pushtetit osman gjatë viteve '30 të shek. XIX u shtyp oxhakëria shqiptare e Kosovës dhe u zhduk pjesa më e madhe e ajanëve shqiptarë.

Në periudhën e Krizës Lindore (1875-1878) e sidomos pas Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878), kur u paraqit rreziku i hapur i copëtimit të trojeve shqiptare ndërmjet shteteve fqinje, rilindësit shqiptarë, për t'i bërë ballë këtij rreziku, në dhjetor të vitit 1877 formuan Komitetin e Stambollit. Pushtimi serb i viseve të vilajetit të Kosovës në sanxhakun e Nishit dhe pushtimi malazez i Tivarit, Podgoricës, Shpuzës, Zhabjakut etj., u përcoll me masakra mbi popullsinë civile shqiptare. Për t'i mbrojtur tokat e veta nga pushtimet e vendeve fqinje, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në krye me Haxhi Ymer Prizrenin thirri më 17 qershor Kuvendin e Përgjithshëm në Prizren, ku u mblodhën rreth 300 delegatë nga Kosova dhe mbarë trojet shqiptare. Kështu Lidhja Shqiptare doli si organizatë e parë politike e ushtarake mbarëshqiptare. Në vitet 1896-1900 nga Kuvendi i Pejës (23-29 janar 1899) u shtrua përsëri kërkesa për formimin e një shteti autonom shqiptar. Ardha në pushtet e Turqve të Rinj (1908), që u ndihmua aq shumë nga shqiptarët, shumë shpejt u kthye në politikë shtypëse të shtetit osman ndaj aspiratave të

tyre për të drejtat politike kombëtare. Gjatë viteve 1909-1912 situata politike në Kosovë u përshkallëzua në kryengritje të armatosura kundër Portës së Lartë. Këto kryengritje ndërkombëtarizuan çështjen shqiptare, duke i dhënë mundësi Austro-Hungarisë dhe Italisë ta çonin deri në fund marrëveshjen e arritur një dekadë me herët për krijimin e shtetit shqiptar. Në luftërat ballkanike 1912-1913 pjesa më e madhe e trojeve shqiptare u pushtuan nga aleatët ballkanikë, por më 28 nëntor 1912 shqiptarët arritën në çastet e fundit ta shpallin Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (dhjetor 1912-korrik 1913) Fuqitë e Mëdha njohën krijimin e Principatës së Shqipërisë dhe shkëputjen përfundimtare nga Perandoria Osmane. Në këtë konferencë u sanksionua gjithashtu copëtimi i gjysmës së trojeve etnike shqiptare, duke u bërë pjesë të monarkive të Serbisë, Greqisë e Malit të Zi. Po në këtë vit në Kosovë përfundoi sundimi pesëshekullor osman, por u zëvendësua me një sundim tjetër edhe më të rëndë, me sundimin serb. (Nehat Krasniqi, Gazmend Rizaj)

KOSOVA Mulla Beqir (shek. XVIII). Poet i letërsisë shqipe alhamiado, ndër më të vjetrit në Kosovë. Lindi në gjysmën e dytë të shek. XVII në një vendbanim me emrin Kosova, i cili u rrënua tërësisht gjatë luftërave austro-osmane në fund të shek. XVII. Jetoj dhe veproj në Pejë. Punoi si myderriz në Medresenë e Vjetër të Pejës në dekadën e tretë të shek. XVIII. Është ruajtur, përmes kopjimit, një poezi e vetme e këtij poeti në gjuhën shqipe me alfabet arab, e cila fillon me vargun: "Shka osht kshtu qi je habit". Nga ky poet është ruajtur edhe një vepër në dorëshkrim, në gjuhën arabe, nga fusha e islamistikës, "Margaritarët e deteve". Vepra është shkruar nga dora e autorit në vitin 1727 dhe është nënshkruar me: Mulla Beqir bin Osman el-Kosofavij (Mulla Beqiri i biri Osmanit Kosovar). Në Pejë ka lënë pasardhës, nga të cilët kanë dalë edhe njerëz të dijes e të penës. (Nehat Krasniqi)

KOSOVA. Aktualisht është shteti më i ri në botë. Shtrihet në pjesën juglindore të Europës, në Gadishullin Ballkanik. Kryeqyteti është Prishtina. Ndodhet ndërmjet 41°51'6" - 43°16'24" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°00'51.4" - 21°47'23.5" të gjatësisë

gjeografike lindore, me sipërfaqe prej 10,887 km². Distanca meridionale është 160 km, kurse distanca ndërmjet pikës perëndimore dhe asaj lindore është 150 km. Vija kufitare e Kosovës me shtetet fqinje është 700,7 km. Në pjesën perëndimore Kosova kufizohet me Shqipërinë, me të cilën vija kufitare është e gjatë 111.8 km. Në jug Kosova kufizohet me Maqedoninë, me një gjatësi të vijës kufitare prej 158.7 km. Në lindje kufizohet me Serbinë në një gjatësi prej 356.1 km. Në pjesën veriperëndimore kufizohet me Malin e Zi, me një gjatësi të vijës kufitare prej 78,6 km. Kosova ka lidhje të mira të komunikimit me rajonet fqinje. Përmes grykës së Konçulit lidhet me Korridorin X, arterien më të rëndësishme të komunikacionit të Europës Juglindore. Përmes grykës së Kaçanikut Kosova lidhet me territorin e Maqedonisë dhe Korridorin VIII. Me Malin e Zi lidhet përmes Qafës së Kullës dhe Rozhajës. Ndërtimi i autostradës Durrës-Kukës-Morinë-Merdar i jep një dimension tjetër pozitës gjeokomunikuese të Kosovës: përmes kësaj autostrade Kosova realizon qarkullim më të shpejtë dhe më cilësor me Shqipërinë dhe brendësinë e Gadishullit Ballkanik.

Edhe pse me një territor relativisht të vogël, me pozitë të ndërlikuar gjeopolitike, me shumë histori, kontradikta, tensione latente e të hapura ndëretnike dhe konfrontime deri në nivel të luftërave, vendi është shumë i pasur dhe në të njëjtën kohë shumë i varfër. Gjithnjë ka paraqitur një nyjë të rëndësishme dhe neuralgjike në Ballkan dhe në fund të shekullit XX (1999) ajo bëhet një çështje më e mprehtë politike dhe ushtarake në shkallë europiane dhe botërore. Në këtë nyjë të trungut gjeoetnik të shqiptarëve u ndeshën edhe dy civilizime, perëndimore dhe lindore, që lanë pasojë të shumënduarshme. Tragjeditë më të mëdha nacionale, ekonomike, politike, sociale etj. shqiptarëve të Kosovës ua ka sjellë injorimi i vullnetit politik dhe ndarjet e njëpasnjëshme, të imponuara dhe të dhunshme.

Kosova veçohet me ndërtimin kompleks gjeologjik dhe tektonik, që manifestohet me shkëmbinj të ndryshëm për nga përbërja dhe vjetërsia. Formacionet proterozoike përfaqësohen me rreshtet kristalore të zonës së Dardanës. Formacionet paleozoike ndërtojnë rajonet e zonës së Vardarit, Sharr-Korabit, të Bjeshkëve të Nemuna etj. Formacionet e mesozoikut kanë shtrirje të gjerë. Dominojnë

ata të moshës triasike dhe kretasike, kurse më pak të përhapur janë ata të jurasikut. Formacionet e kenozoikut marrin pjesë në ndërtimin gjeologjik të fushëgropave tektonike të Dukagjinit, Kosovës, Drenicës, Llapit, Gjilanit dhe Strezoc-Kamenicës. Shtresimet kuaternare ndërtojnë rajonet fushore dhe paraqiten sidomos përgjatë shtretërve të lumenjve të mëdhenj. Përfaqësohen nga sedimentet e tarracave të lumenjve, depozitimet aluviale, diluviale, proluviale, formacionet morenike etj. Në aspektin gjeotektonik, në Kosovë veçohen këto zona tektonike: zona e Dardanës, e Vardarit, e Drenicës, e Mirditës, e Bjeshkëve të Nemuna dhe zona e Sharr-Korabit. Territori i Kosovës ka lartësi mesatare mbidetare prej 800 m. Ai karakterizohet nga copëzimi i theksuar vertikal dhe format e ndryshme të relievit. Në aspektin morfologjik dallohet rajoni malor dhe ai fushor. Në pjesën jugore dhe jugperëndimore shtrihen Malet e Sharrit, të Koritnikut dhe të Pashtrikut. Brenda këtyre njësive të individualizuara morfologjike ndodhen tërësi më të vogla, çfarë janë Gora, Podguri i Prizrenit, Dragashi dhe Hasi. Rajonit malor perëndimor i takojnë Bjeshkët e Nemuna, ku bëjnë pjesë malet e Junikut, Deçanit, Kozhnjerit, Lumëbardhit dhe Koprivnikut. Këtu ndodhet edhe maja më e lartë, Gjeravica, me 2,656 m. Në verilindje të Kosovës shtrihet rajoni malor i Kopaonikut, të cilit i takojnë malet e Rogoznës dhe Kopaonikut (2,017 m). Në pjesën qendrore shtrihen malet e Drenicës, ku bëjnë pjesë: Drenica, Kozmaqi, Çiçavica, Goleshi, Milanovci, Carraleva etj. Në pjesën jugore shtrihen shpatet veriore të Karadakut. Në relievin e Kosovës dallohen qartë edhe rajonet pak të valëzuara dhe të sheshta, të cilat përbëjnë 36,5% të territorit. Këtu bëjnë pjesë rrafshnaltat, ultësirat, fushat ndërmallore dhe fushëgropat. Në pjesën lindore gjendet Fusha e Kosovës, me një shtrirje veri-veriperëndim-jug-juglindje ndërmjet Ferizajt dhe Mitrovicës. Në pjesën perëndimore shtrihet Rrafshi i Dukagjinit; ai ndodhet ndërmjet brezit malor të Malit të Thatë, Drenicës, Carralevës në lindje dhe Bjeshkëve të Nemuna në perëndim. Në luginat e disa lumenjve ndodhen edhe ultësirat me shtrirje të kufizuar, si ajo e Moravës së Binçës, Drenicës, Llapit etj.

Klima është e mesme kontinentale me ndikime të klimës mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit dhe të klimës kontinentale në Rrafshin e



HARTA E KOSOVËS

Kosovës. Rrafshi i Dukagjinit është më i ngrohtë dhe merr më shumë reshje shiu e bore se ai i Kosovës, që dallohet me më pak reshje, me dimra të ftohtë dhe me erëra nga veriu. Vlera mesatare e ditëve me diell për pjesët e ulëta të Kosovës është 2,055 orë/vit. Temperatura mesatare vjetore sillet nga -0.6°C në muajin janar deri në 20.6°C në muajin korrik. Sasia mesatare e reshjeve lëviz prej 600 mm në Rrafshin e Kosovës deri në 800 mm në Rrafshin e Dukagjinit. Në viset malore sasia e reshjeve sillet prej 800 mm deri në 1300 mm. Ujërat nga

territori i Kosovës rrjedhin në tri nga pesë detet e Gadishullit Ballkanik. Suka e Dermanit (1,364 m) është nyja hidrografike, nga e cila ujërat rrjedhin në drejtim të detit Adriatik, Detit të Zi dhe detit Ege. Kosova karakterizohet me përputhshmërinë e lartë ndërmjet sipërfaqes shtetërore (10,887 km²) me sipërfaqen topografike (11,645 km²). Kjo rezulton që sipërfaqja topografike e ujëmbledhësve lumorë të jetë vetëm 6.5% më e madhe se ajo shtetërore. Ky fakt tregon se rrjeti lumor i vendit krijohet në brendi të territorit shtetëror dhe se është

kryesisht autokton. Dendësia mesatare e rrjetit lumor është rreth 800 m/km². Rrjeti hidrografik i Kosovës përbëhet prej katër sistemeve lumore: Drini i Bardhë, Ibri me Sitnicën, Morava e Binçës dhe Lepenci me degët e tyre. Sasia mesatare e prurjeve vjetore është 113 m³/sek, nga të cilat 58.4% derdhen në detin Adriatik, 32.7% në Detin e Zi dhe 8.9% në detin Egje. Kosova me vlerën mesatare të modulit të rrjedhjes prej 10.5 l/s/km² ka vlerë më të madhe se pellgjet lumore të vendeve fqinje. Pasuritë ujore të Kosovës vlerësohen rreth 3,608 milionë m³. Ajo mesatarisht ka 1,700 m³/banor/vit. Kosova ka 90% ujëra vendore (domicile) dhe vetëm 10% ujëra transite.

Kosova ende paraqet transicionin e fundit demografik në Europë, me të gjitha pasojat që bart ky proces (norma e lartë e fertilitetit, struktura e re e popullsisë, niveli i ulët i popullsisë aktive, shkalla e lartë e mortalitetit të foshnjave etj.). Një ndër veçoritë kryesore të zhvillimit të popullsisë për një kohë të gjatë është rritja e numrit të saj, edhe pse ka pasur procese intensive emigruese në periudha të caktuara historike-shoqërore. Derisa në vitin 1880, vlerësohet se ajo kishte rreth 240,000 banorë, në vitet 1908-1909, sipas statistikave turke, Kosova kishte 506,862 banorë. Autoritetet ushtarake austriake në vitin 1916 japin shifrën prej 460,607 banorësh. Në periudhën 1880-1980 popullsia e saj rritet për më se 600%. Në procesin e "shpërthimit demografik" Kosova hyri në vitet '60 të shek. XX, kur rritja e numrit absolut të shtimit natyror shënon rritje, si rrjedhojë e rënies së mortalitetit dhe nivelit të lartë të natalitetit. Në periudhën 1948-1991 popullsia e saj rezidenciale shtohet për nga 733,034 në 2,018,512 banorë ose për 175%, ndërsa në periudhën 1948-2005 (2,502,000 vlerësimi) popullsia e saj shënon një rritje për 241%. Rritja është rezultat i normave të larta të lindshmërisë dhe të shtimit natyror, që ka relativizuar emigrimin. Emigrimi ka gëlltitur një sasi të konsiderueshme të këtij shtimi dhe saldoja migruese ka rezultuar të jetë negative. Kosova sot ka dy herë dendësi më të madhe se vendet e rajonit. Derisa në vitin 1948 në 1 km² jetonin 67.3 banorë, në vitin 1971 rreth 114.2, ndërsa në vitin 1991 rreth 180, kurse sot vlerësohet se kjo dendësi është rreth 200 b/km². Karakteristikë tjetër sociodemografike është numri, madhësia dhe përbërja e ekonomive familjare. Në Kosovë tradicionalisht

kishte shumë anëtarë për ekonomi familjare dhe madhësia mesatare e tyre shënonte rritje të vazhdueshme. Në vitin 1961, Kosova kishte 43,707 ose 28.7% të ekonomive familjare me 8 e më tepër anëtarë, ndërsa në vitin 1981 ky numër rritet në 80,823 ose 35.3% nga numri i përgjithshëm. Te këto ekonomi familjare dominonte tipi i familjeve të zgjeruara, ku shumica jetonte në territoret rurale. Deri vonë familjet ishin institucioni më karakteristik dhe dominues i organizimit shoqëror të shqiptarëve të Kosovës. Si rezultat i transformimeve ekonomiko-shoqërore, pas viteve '60 të shekullit të kaluar, intensifikimit të procesit të urbanizimit, emigrimit dhe punësimit të popullsisë në botën e jashtme, erdh deri te ndryshimi i madhësisë dhe përbërjes së ekonomive familjare: rritet numri i ekonomive të vogla familjare, ndërsa fillon të shtohet edhe numri i ekonomive familjare me burime të përziera dhe jobujqësore. Me gjithë tendencat e pushteteve të ndryshme për pasqyrimin jo të drejtë të strukturës etniko-demografike, në bazë të të dhënave nga periudha të ndryshme vërehet se popullsia shqiptare përbënte vazhdimisht shumicën dërrmuese. Nga statistikave turke të viteve 1908-1909, shqiptarët përbënin 81.6%, ndërsa sipas statistikave austriake të vitit 1916 del që shqiptarët përbënin 78.2% të popullsisë së Kosovës. Ndonëse kishte shumë mangësi në rastin e deklaramit të popullsisë sipas përkatësisë gjuhësore, në vitin 1921 prapëseprapë 65.8% e popullsisë regjistrohesh si shqipfolës, ndërsa në regjistrimin e vitit 1931, mbi 60% e popullsisë deklarohen se shqipen e kanë gjuhë amtare. Trendi i rritjes së pjesëmarrjes së shqiptarëve në strukturën kombëtare vazhdon edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe, sipas regjistrimeve zyrtare, gjendja ishte kështu: 1948-68.5%, 1953-64.3%, 1961-67.2%, 1971-73.7%, 1981-77.4% dhe 1991-81.6% (vlerësimi). Sot më se 90% të popullsisë e përbëjnë shqiptarët. Nga pakicat jetojnë serbët, boshnjakët, romët, turqit dhe të tjerët, që së bashku përbëjnë 7-8% të popullsisë së gjithëmbarshme.

Kryeqendra e Kosovës është Prishtina, me funksione politike, administrative, ekonomike, kulturore dhe arsimore. Qendrat e tjera rajonale janë: Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjilani, Gjakova dhe Ferizaj. Të gjitha qendrat rajonale në Kosovë kanë universitete publike. (Hivzi Islami, Arsim Ejupi)

KOSOVARISHTJA. Emërtim për shqipen e Kosovës dhe mëtimet për koineizimin e saj. Në Perandorinë Osmane dhe më tej në ish-Jugosllavi shqipja e Kosovës ka pasur status të gjuhës popullore. Përvojat e para të kultivimit dhe të elaborimit të saj nisin me shkollat e rralla private në fund të shekullit XIX dhe në dekadat e para të shekullit XX. Kjo fazë ka një ndërprerje nga shteti serb deri në Luftën e Dytë Botërore, kur një pjesë e Kosovës u bashkua me Shqipërinë dhe u hapën shkolla fillore e të mesme me mësim në gjuhën shqipe. Pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht pas vitit 1952, ka lëvizje drejt planifikimit të gjuhës. Në mbledhjen e vitit 1952, të organizuar nga pushteti i atëhershëm krahinor për arsim, u vendos për të pasur në përdorim variantin gegë me bazë elbasanishten, duke shpërfillur mendimet për krijim të një varianti kosovar. Mbledhja e vitit 1957 kërkonte afrimin më të madh me gjuhën e folur. Më 1968, në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës hiqet dorë nga kjo praktikë e standardizimit që kishte kulmuar me ortografinë e vitit 1964, që mund të konsiderohet edhe drejtshkrimi i fundit i gegnishtes. (Hana Radoniqi)

KOSOVARIZMAT. Forma gramatikore dhe fjalës i të folmeve shqipe të Kosovës. Shqipja e Kosovës bën pjesë kryesisht në kuadrin e të folmeve verilindore të gegërishtes, ndonëse ka edhe disa të folme të gegërishtes veriperëndimore, ndërsa në pjesën më jugore të të folmeve të Kaçanikut shtrihet drejt të folmeve të gegërishtes së mesme. Në Kosovë ka dallime mes grupit të të folmeve të Rrafshit të Dukagjinit (Deçan-Gjakovë) dhe Fushës së Pejës e të folmeve të Drenicës, në një anë, dhe të folmeve të Rrafshit të Kosovës, të Moravës së Epërme, të Karadakut, të Llapit e Gollakut, në anën tjetër. E folmja e muhaxhirëve të shpërngulur në shek. XIX nga Toplica e Kosanica është shkruar në të folmet e Rrafshit të Kosovës. Shqipja popullore ka qenë gjuhë e popullatës shumicë në Kosovë gjatë periudhës osmane dhe gjatë sundimit të ish-Jugosllavisë. Ndër kosovarizma mund të konsiderohen format foljore të tipit: jam tue punu, jom shku; ndikime dhe kalke të serbishtes dhe një fjalës, i cili është përmbledhur në një fjalor të botuar në Institutin Albanologjik më 1980. (Agnesa Hasimja)

KOSTANDIN Mihali i Ostrovicës (rreth 1435-pas vitit 1501). Shkrimtar dhe ushtarak nga Novobërda. Ishte dëshmitar i rëndësishëm i dramës të pushtimeve osmane, sidomos të Novobërdës dhe rrethinës së saj. Lindi rreth vitit 1435 në një familje minatorësh ose tregtarësh në Novobërdë. Mori pjesë me një njësit të vogël vasalësh në rrethimin e Konstandinopojës në vitin 1453, ndërsa më pas u gjend mes banorëve në Novobërdë, kur qyteti ra në dorë të osmanëve (më 1 qershor 1455). Në mesin e robërve ishte edhe Kostadin Mihali, i cili u dërgua për jeniçer dhe mori pjesë në shumë ekspedita të sulltan Mehmetit II: në Beograd, Peloponez, Arbëri etj. Në Bosnjë, më 1463 u kap rob nga ushtria e mbretit hungarez, Matej Korvin. Pas lirimt nga hungarezët, u vu në shërbim të planeve për krijimin e një aleance politike kundër turqve. Mes viteve 1497-1501 shkroi veprën “Kujtimet e jeniçerit”, si memorandum politiko-historik dedikuar mbretit polonez, Jan Olbraht, dhe mbretit hungarez, Vladislavi II. Ndonëse teksti i “Kujtimeve” nuk është ruajtur në tërësi, megjithatë kanë mbetur vetëm ca kopjime në dorëshkrim të përkthimit në polonisht (“Hystorya neb Kronyka Turecká od Michaala Konstandina z Ostrowicze”). Pas ekspeditave si jeniçer, Kostandin Mihalit i humbin gjurmët për një kohë, por dihet se kishte ikur nga osmanët dhe u kthye në mesin e të krishterëve. (Jahja Drançolli, Faik Sahiti)

KOSTARI Stathi (1918-1987). Veprimtar i arsimit. Lindi në Hoshtevë, Shqipëri. Pas shkollës fillore, kreu Normalen e Elbasanit. Më 1941 emërohet mësues në shkollën fillore të Rahovecit. Ishte përgjegjës i arsimit në Rahovec, ndërsa në fund të vitit 1946 e vazhdoi punën në Drejtoratin Arsimor të Kosovës, si anëtar i Komisionit Pedagogjik, i cili u mor me hartimin e teksteve shkollore, me hartimin e planeve dhe programeve, me organizimin e kurseve për kualifikimin e mësuesve etj. S. Kostari ishte bashkautor i Abetares për të rritur (1946), i doracakut metodik “Udhëzime për mësimin e lexim-shkrimit për kl. I të shkollës fillore”, si dhe i librave të leximit për klasën e dytë dhe të katërt të shkollës fillore. Një kohë ishte redaktor i SHB “Mustafa Bakija” në Prishtinë dhe i redaksisë së kulturës të Radio-Prishtinës, pastaj sekretar i Pleqësisë së Arsimit të Kosovës. Bashkëpunoi me revistat “Jeta e

re” dhe “Përparimi” në Prishtinë. U mor me kritikë letrare. (Ali Lllunji)

KOSTERCI. Njëra nga zhupat e krijuara në fund të shek. XII. Nga burime të shkruara të Kishës së Rashës nuk mund të mësohet se cilat vendbanime i përkisnin kësaj zhupe, e cila përmendet bashkë me të tjerat (Hvosno, Dërshkovina, Kujavça, Zatërnavë, Podrima, Vuçiterna, Llapi e Lipjani), që zhupani i madh i Rashës, Stefan Nemanja, i kishte pushtuar në vitin 1198 nga “toka greke” e Bizantit. Kosterci mund të ketë qenë qendër e zhupës së Podrimes. Kemi të bëjmë me katundin e sotëm Kosterc të komunës së Suharekës. Po me këtë emër, ky vendbanim përmendet edhe në vitin 1327 si “Kostrāca”. Në vitin 1348 dëshmohet si vendbanim i vllahëve, ndërsa në një defter osman të vitit 1571 është regjistruar si Kostreç, përkatësisht Kostrec. Historianë e lingvistë pajtohen që emri Kosterc duhet interpretuar si një trajtë deminutive sllave e fjalës latine *castrum*, “kështjellë”. Emra të dalë si formime sllave nga fjala latine që u gjetën në përdorim nga vendësit joslavë ka në hapësirat e serbishtes, kroatishtes e të bullgarishtes dhe, si relikte sllave edhe në Greqi e në Shqipëri, madje deri edhe në Istri. (Skënder Gashi)

KOSTIQ (Kostić) Sllobodan (1952-2012). Poet i letërsisë serbe nga Kosova. Lindi në Reçan afër Kamenicës. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, gjimnazin në Kamenicë, studimet e letërsisë në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Ishte gazetar në gazetën ditore “Jedinstvo” deri në vitin 1979, më pas punoi në katedrën e letërsisë serbokroate të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Me poezitë e tij u përfaqësua në disa antologji të letërsisë serbe dhe ishte laureat i një sërë çmimesh letrare. Veprat e botuara nga fusha e poezisë dhe e kritikës: “Fisheku mbi tabaka” (1977), “Leximi i hartës” (1983), “Rrënjësoret”(1987), “Këngët e pendimit” (2000), “Poezia e re serbe në Kosovë” (1981), “Krijimi dhe interpretimi” (1990), “Poezia fetare ortodokse” (2000). Botoi edhe libra në prozë: “Udhëtari nëpër kujtime dhe shenjtërime” (2010), “Rruga” (2011) etj. (Ismet Markoviq)

KOSTIQ Millutin (Milutin Kostić) (1942-). Skenograf. Lindi në Llapna Sellë të komunës së Prishtinës. Kreu studimet për skenografi

në Akademinë e Arteve të Universitetit të Beogradit. Në Teatrin Popullor Krahinor punoi që nga viti 1952, ku realizoi skenografitë për një numër shfaqjesh me trupën e dramës serbe dhe shqipe, nga të cilat veçohen: “Nita”, “Hotel Kashta”, “Othello”, “Dundo Maroje”, “Ushtari i mirë Shvejk”, “Mbreti i Betanjovës”, “Karrigia që luhetet”, “Zona e Zanfirit” etj. Për skenografitë e realizuara mori çmime të ndryshme nga institucionet dhe asociacionet e vendit, si dhe çmimin për skenografinë më të mirë në Takimet teatrore “Joakim Vujiq” (Kragujevc, Serbi) në vitet 1984 dhe 1985. (Besim Rexhaj)

KOSUMI Bajram (1960-). Politikan, shkrimtar, publicist, mësimdhënës universitar. Lindi në Tygjec të Kamenicës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Koretin dhe në Kamenicë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (UP), ku edhe doktori në vitin 2008. Ishte njëri nga organizatorët e demonstratave të vitit 1981, për çka u dënua me 15



BAJRAM KOSUMI

vjet burg. Pas lirimimit nga burgu, në fund të vitit 1990 punoi si publicist, redaktor dhe kolumnist i revistës “Zëri” dhe në disa gazeta të tjera. Në zgjedhjet e para shumëpartiake të organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga Kamenica (1992). Ishte kryetar i Partisë Parlamentare të Kosovës (PPK) në periudhën 1994-2000 dhe anëtar i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë (1999). Në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (1999) ishte ministër i Informimit Publik. Pas luftës u bë bashkëthemelues i koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe më pas i partisë me të njëjtin emër (AAK) dhe nënkryetar i saj (2000-2010). U zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës në tri legjislatura (2001-2010), pastaj ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor (2004) dhe një periudhë edhe kryeministër i Qeverisë së Kosovës. Nga fusha e letërsisë botoi disa vepra: “Libri i lirisë” (1992), “Fjalor i barbarëve” (2000), monografinë “Lirika e Fishtës” (2004) etj. Në vitin 2008 u zgjodh mësimdhënës në departamentin e gazetarisë të Fakultetit të Filologjisë të UP-së, ndërsa në shtator të vitit

2015 rektor i Universitetit të Gjilanit. (Nerxhivane G. Dauti)

KOSUMI Gani (1955-). Gazetar i sportit. Lindi në Tugjeç të Kamenicës. Shkollimin filor dhe të mesëm i kreu në Prishtinë. Mbaroi studimet në degën e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Fillimet e gazetarisë sportive i bëri në gazetën studentore “Bota e re”. Në vitin 1981 nis punën e gazetarit të sportit në Radio-Prishtinë, ku raportoi për sportin universitar. Në periudhën 1991-1999 raportoi për Radiotelevizionin Shqiptar për të gjitha ngjarjet sportive që zhvilloheshin në Kosovë. Pas vitit 1999, dy vjet punoi redaktor i sportit në Radio “Rilindje”, kurse më pas kthehet në Radio-Kosovë si redaktor i redaksisë së sportit. Ka qenë edhe redaktor i gazetës “Kosova sport”. Ka bashkëpunuar me të gjitha gazetatat dhe revistat në Kosovë dhe në Shqipëri. Për punën në gazetari është nderuar me mirënjohje të ndryshme nga organizatat e sportit në Kosovë, në Maqedoni, në Shqipëri dhe në diasporë. Është shpallur gazetar i vitit për sportet luftarake në Kosovë, gazetari më i mirë për radio etj. (Besim Kajtazi)

KOSHARJA Sefë (?-1881). Njëri ndër anëtarët më aktiv të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lindi në fshatin Koshare të Ferizajt. Si luftëtar u dallua në pritën e organizuar nga forcat vullnetare të Lidhjes Shqiptare së Prizrenit, më 21 prill të vitit 1881, në afërsi të fshatit Koshare, kundër ushtrive osmane të udhëhequra nga Dervish Pasha. Pas një beteje kundër forcave osmane, S. Kosharja u plagos dhe u kap i gjallë. Autoritetet osmane kërkuan prej tij që të dënonte veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por ai nuk pranoi. Më 21 prill të vitit 1881, Dervish Pasha e vari në maje të një lisi, në prani të fshatarëve. Pas varjes së tij, Dervish Pasha mori masa të ashpra ndaj të gjithë atyre që kishin mbështetur Lidhjen, në Koshare dhe në anën e Shtimes. (Luan Tetaj)

KOSHI Neshet (1942-). Gjumnast, gjyqtar i gjumnastikës artistike, mësimdhënës. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën e mesme në Prishtinë dhe u diplomua në Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd (1965). Studimet e magistraturës i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, ndërsa disertacionin e doktoraturës e mbrojt

në Fakultetin e Kulturës Fizike në Beograd (1989). Një kohë ishte mësimdhënës i edukatës fizike në “Gjumnazin 12” të Beogradit (1965-1967) dhe më pas në Prishtinë, në Shkollën e Lartë Pedagogjike (1967-1979). Në vitin 1980 u zgjodh docent në Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit të Prishtinës (1980-1991) dhe më pas në Akademinë e Arteve (1997-2003). U mor edhe me sport. Ishte gjyqtar federativ i gjumnastikës artistike të Jugosllavisë, anëtar i përfaqësueses së Jugosllavisë në gjumnastikën artistike (1964) dhe anëtar i ekipit të qytetit të Beogradit në gjumnastikën artistike (1965). (Moral Pozhegu)

KOTORRI. Qytet dhe port detar në Malin e Zi. Shtrihet në territorin e një vendbanim të lashtë ilir, që i takonte fisit të ardianëve. Gjatë periudhës greke kishte statusin e kolonisë. Pasi



KOTORRI

bie nën pushtetin romak, si pjesë e provincës së Dalmacisë do të identifikohet me emrin Acruvium (168 p.e.r.). Në mesjetën e hershme, për qëllime mbrojtëse nga depërtimet sllave, perandori Justinian (535) kishte fortifikuar Kotorrin me mure mbrojtëse. Në shek. X sistemi mbrojtës u zgjerua edhe më tepër, duke rritur hapësirën e qytetit. Me ndërtimet që i bëri Konstandin Porfirogeneti, Kotorri ishte shndërruar në një qytet të fortifikuar të pjesës jugore të Adriatikut. Në shek. IX qyteti u kishte bërë ballë sulmeve arabe. Gjatë mesjetës së zhvilluar Kotorri me rrethinë është konsideruar si njëra ndër pikat më veriore të shtrirjes territoriale etnike të arbërve. Rrethina e tij e njohur si Zhupa e Gërbalit (Grebli, Grbal) ishte e banuar edhe me popullatë autoktone arbërore, gjë që dëshmohet edhe nga Statuti i Komunës autonome të Kotorrit. Në

vitin 1066, me rastin e shugurimit të Kishës së Shën Trifonit (Trifunit) në Kotorr përmendet si pjesëmarrës edhe ipeshkvi arbëror. Nga viti 1391 deri më 1420 ishte komunë e pavarur, me statut dhe qeverisje autonome. Gjatë kësaj kohe një numër i madh i tregtarëve nga ky qytet zhvillonte veprimtari tregtare dhe fetare në qendra mesjetare xehetare të Kosovës, si në Pejë, Trepçë, Janjevë, Novobërdë, Prishtinë, Prizren etj. Një kohë Kotorrin e zotëruan edhe princërit e familjes Balshaj. Nga viti 1420 qyteti ra nën venedikasit, nën pushtetin e të cilëve qëndroi deri më 1797. (Muhamet Mala)

KOVAÇEVIQ Aleksandar (Kovačević) (1931-). Regjisor. Lindi në Kraljevë. Kreu studimet për regji teatri në Akademinë e Arteve në Beograd. Realizoi një numër të madh premierash në të dyja ansamblet e Teatrit Popullor Krahinor, në gjuhën shqipe dhe serbe. Bëri regjinë e shfaqjeve që nga fillimi i viteve '60 dhe deri në fund të viteve '80, si: "Flaka fisnike", "Zonja ministreshë", "Bora dhe zjarri", "Po shkoj për gjah", "Fosilet", "Nita", "Duart e papastra", "Vajza pa prikë", "Mollët në lulëzim", "Karrigia që luhatet", "Ruj Blaz", "Rruga e zhvillimit të Bora Shnajderit", "Zona e Zamfirrit", "Ligësitë dubrovnikase", "I ndjeri" etj. Për regjinë e disa nga shfaqjet ka marrë çmime në festivale teatrore. (Besim Rexhaj)

KOVAÇI Hajredin (1960-). Poet. Lindi në Draginë, komuna e Ulqinit. Kreu shkollimin në Katërkollë dhe Ulqin. Gjatë kohës kur ishte student i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, në vitin 1981, u arrestua dhe u dënua me dy vjet burg. Është një nga themeluesit e subjektit të parë politik të shqiptarëve në Malin e Zi, Lidhjes Demokratike në Mal të Zi. Fillimisht poezitë e tij i botoi në revistat e ndryshme në Kosovë dhe Mal të Zi, më pas botoi përmblendhjet: "Ecje pa mbarim" (2000), "Fundi është larg" (2007), "Vrasja e frikës" (2012) dhe "Zhdrukja e heshtur" (2014). Jeton në Ulqin dhe është udhëheqës i shoqatës "Studenti", që merret me veprimtari kulturore e studentore. (Haxhi Shabani)

KOVAÇICA Ukshin (1904-1947). Veprimtar i lëvizjes nacionaliste dhe antikomuniste. Lindi në Kovaçicë të Shalës së Bajgorës. Familja e tij ishin kushërinj me Isa Boletinin. I ati i tij u plagos dy herë në betejat në kullën e Isa Boletinit.

Në kullën e tij në vitin 1945 u zhvilluan lufta 11-ditëshe me brigadat partizane. U vra në malet e Vllahisë në shkurt të vitit 1947. Sipas të dhënave jugosllave, në betejën e kullës së U. Kovaçicës ishin vrarë 45 ushtarë, një kapiten dhe një major dhe ishin shpallur të humbur 200 veta, ndërsa në luftërat e tjera, si në Bare dhe malet e tjera të Shalës, ishin vrarë edhe 120 veta. (Fehmi Pushkolli)

KOXHABALLKANI. Masiv malor në pjesën veriore të Maleve të Sharrit, që shtrihet ndërmjet malit Oshlak (2,212 m) në jug, deri te Mushtishtinë veri. Zona e gjerë e Koxhaballkanit karakterizohet me ndërtim specifik gjeologjik, ku veçohet melanzhi olistostromik, ultramafitet dhe shkëmbinj të metamorfikë. Melanzhin e përbëjnë kryesisht pelitet e metamorfizuara dobët, të cilat paraqesin matriksin e melanzhit, ku janë të vendosura gëlqerorët e moshës së triasikut, si klastite dhe olistolite. Lartësia absolute mbidetare është 2,092 m (Pashallarë). Veçohet Maja Trekufi (1,934 m), që paraqet ujëndarësin ndërmjet Lepencit (deti Egje) dhe Toplluhës (deti Adriatik). Në masivin e Koxhaballkanit burojnë degë të rëndësishme të lumenjve të Lepencit dhe të Toplluhës. Bimësia përfaqësohet nga shkurret e dredhakut, pyjet halore (rrobulli, arneni). Pjesët më të larta janë të zhveshura. (Valbon Bytyçi)

KOXHAJ Lefter (1969-2001). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Nishovë të Skraparit. Punoi në ndërtimtari, më pas emigroi në Greqi. Kur filloi lufta në Luginën e Preshevës, vendosi të shkonte në atë luftë. Por në Gjilan i bashkohet një grupi luftëtarësh, që bënin përgatitje për luftë në Maqedoni. Së bashku me një grup tjetër shqiptarësh formuan njësitin luftarak me qendër në fshatin Sllubčan, duke u inkuadruar më pas në radhët e Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Njësitin e komanduar nga L. Koxhaj zhvilloi luftime në Mateq, në gjithë zonën e Karadakut, si dhe në Haraçinë. Natën e 6 gushtit 2001 u nis me grupin e tij për një aksion në qytetin e Shkupit, por më 7 gusht u vra nga policia maqedonase. (Dilaver Goxhaj)

KOZNIKU Ardian (1967-). Futbollist, trajner. Lindi në Gjakovë. U zhvillua si futbollist në KF "Vëllaznimi", ndërsa në vitin 1988 iu bashkua "Prishtinës". Nisi karrierën ndërkombëtare më

1990, kur iu bashkua “Hajdukut” të Splitit. Pas katër vjetësh luajti dy stinorë në “Cannes” të Francës (1994-1996), më pas kalon te skuadra tjetër franceze, “Le Havre” (1996/97). Në vazhdim, luajti me ekipin qipriot, “Apoel” (1997), pastaj u kthye përsëri në Francë, te “Bastia” (1998). Më vonë u rikthye në Kroaci, por te “Dinamo” e Zagrebi, ku qëndroi dy vjet (1998-2000). Kozniku e kaloi një edicion në ekipin austriak, FC “Kärnten”, për ta mbyllur karrierën në skuadrën kroate “Hrvatski Dragovoljac” (2002). Në edicionin 2014/15 drejtoi skuadrën “Shkëndija” të Tetovës. (Moral Pozhegu)

KRAHE Hans (1898–1965). Gjuhëtar gjerman. Studioi në Universitetin e Jenës për gjuhësi krahasimtare, gjermanistikë dhe romanistikë. Më 1924 doktoroi me temën “Emrat e vjetër gjeografikë të ilirishtes së Ballkanit” (Die alten balkanillyrischen geographischen Namen), ndërsa më 1928 e mbrojti temën e habilitacionit “Leksikon i emrave personalë të ilirishtes së vjetër” (Lexikon altillyrischer Personennamen). Me botimin e këtyre dy veprave më 1925 dhe 1929, si dhe me publikimet e shumta të mëvonshme, u bë shumë i njohur në fushën e studimeve mbi ilirishten. Nga viti 1934 punoi si profesor i gjuhësisë krahasimtare indoeuropiane në Universitetin e Vyrzburgut. Nga viti 1947 profesor në Universitetin e Heidelbergut dhe nga viti 1950 e deri në vdekjen profesor për gjuhësi krahasimtare dhe për sllavistikë në Universitetin e Tübingenit. U ndikua nga tradita e junggramatikanëve e indoeuropianisht në Gjermani dhe e vazhdoi këtë traditë edhe si redaktor i vjetarit “Indogermanisches Jahrbuch” (1940-55) dhe si bashkautor i revistës “Indogermanische Forschungen” (1944-1965). Rezultatet më të mëdha të tij janë në fushën e studimeve të emrave të lashtë të vendeve e të ujërave (hidronimeve). Përmes mbledhjes dhe analizimit sistematik të emrave, Krahe kontribuoi në zbardhjen e historisë së gjuhëve dhe të popujve të Europës, e me këtë edhe të ilirishtes. Më 1955 botoi librin “Gjuha e ilirëve. Pjesa 1.: Burimet” (Die Sprache der Illyrier. 1. Teil: Die Quellen), me të cilin e hapi rrugën për trajtimin e historik të çështjes ilire. (Milote Sadiku)

KRAHINAT ETNOGRAFIKE. Janë njësi të vogla ekonomiko-shoqërore, të cilat u formuan historikisht në një territor të caktuar. Këto kra-

hina, megjithëse kanë një bazë etnike të përbashkët, si rrjedhim i kushteve të veçanta të jetës, i marrëdhënieve të veçanta ekonomiko-shoqërore, i fateve të veçanta historike etj., krijuan në mes të tyre edhe nuanca të lehta gjuhësore, ndryshime të vogla traditash kulturore etj., që u shprehën edhe me ndërgjegje shoqërore dhe me emër të tyre të veçantë. Në hapësirat shqiptare gjatë shekujsh u formuan mjaft krahina etnografike, si Rugova, Drenica, Hasi etj. Në përcaktimin e krahinave (rajoneve) etnografike kanë rëndësi të posaçme elementet etnografike, si: veshja, doket e zakonet, por edhe gjuha e disa elemente të tjera (antropologjike, psikologjike etj.). Edhe faktorët gjeografikë me rastin e përcaktimit të rajoneve etnografike luajnë një rol të rëndësishëm. Madje, shpeshherë një tërësi etnografike është njëkohësisht edhe tërësi gjeografike, e përcaktuar para së gjithash me karakteristikat e relievit dhe të pozitës gjeografike në përgjithësi. Kosova ndahet në dy regjione kryesore, në fushën e Kosovës në lindje dhe në Rrafshin e Dukagjinit në perëndim. Rajone gjithashtu të mëdha, por më të vogla se këto janë Drenica (ndërmjet Kosovës e Dukagjinit) dhe Morava (ndërmjet Kosovës dhe Preshevës). Në periferinë e këtyre rajoneve kryesore ndodhen shumë krahina më të vogla, që së bashku quhen Kosovë, sipas krahinës më të madhe e më të njohur midis të gjitha të tjerave. (Bashkim Lajçi)

KRAJA Arzana (1981-). Regjisore e filmi dhe e televizionit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe atë të mesme, ndërsa studimet për regji filmi i kreu në degën e regjisë të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës. Ka punuar si regjisore, asistente e regjisë dhe producente në disa televizione dhe produksione vendore. Ka qenë njëra nga themelueset dhe udhëheqëse e departamentit të filmit në Festivalin Ndërkombëtar Studentor për Film e Teatër - Skena UP (2002-2007). Është autore e tetë filmave të shkurtë, si: “Kulla e sahatit” (2009), “Shkurta” (2011) etj., si dhe e tre filmave dokumentarë, nga të cilët edhe “Përmes syve të mi,” mbështetur nga zyra e BE-së në Kosovë. Së fundi ka përfunduar xhirimin e filmit të metrazhit të gajtë “Fusha e mëllenjave,” i subvencionuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Filmi është kooproduksion i Kosovës, Shqipërisë dhe i Britanisë së Madhe. (Doruntina Basha)

KRAJA Garentina (1978-). Gazetare. Lindi në Prishtinë, shkollën fillore dhe të mesme i përfundoi në Prishtinë, ndërsa studimet universitare i kreu në Universitetin e Jelës (SHBA), ku mori titullin master në shkencat politike. Karrierën në gazetari e filloi me themelimin e të përditshmes “Koha ditore” (1997), fillimisht duke mbuluar aktivitetet kulturore, pastaj protestat studentore si dhe gjendjen e rëndë ekonomike e të sigurisë gjatë periudhës së represionit serb në Kosovë. Gjatë vitit 1998 ishte njëra nga gazetarët që ndoqën daljen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në skenë dhe në baza ditore mbuloi përshkallëzimin e situatës në Kosovë. Pas hyrjes së trupave të NATO-s vazhdoi punën në gazetari, si korrespondente e agjencisë amerikane të lajmeve “Associated Press” në Prishtinë deri në prag të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Në vitin 2006 u përzgjedh në programin prestigjioz “Yale World Fellows”. Në vitin 2011 u emërua këshilltare për politikë të jashtme dhe siguri e presidentes së Republikës së Kosovës. (Ibrahim Berisha)

KRAJA Mehmet (1952-). Romancier, tregimtar, publicist, dramaturg, akademik. Lindi në fshatin Kështenjë të Krajës, afër Liqenit të Shkodrës. Kreu shkollën fillore në Ostros, gjimnazin



MEHMET KRAJA

në Ulqin, ndërsa studimet universitare për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Gjatë studimeve për një kohë ishte kryeredaktor i gazetës studentore “Bota e re”, ndërsa nga viti 1974 punoi në të përditshmen “Rilindja”, gazetar dhe redaktor. Në fillim të viteve '90 u përfshi në zhvillimet politike të kohës dhe ishte njëri nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Disa vjet punoi si redaktor i kulturës në botimin e Tiranës të gazetës “Rilindja”. Më pas punoi redaktor i kulturës në gazetën “Zëri” dhe redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën e përditshme “Koha ditore”. Nga viti 2002 ishte mësimdhës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Më 2004 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, nërsa nga vitit 2008 është anëtar i rregullt. Me shkrime letrare u shfaq në

fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Brenda harkut kohor dyzetvjeçar botoi mbi njëzet vepra letrare: romane, tregime, drama, ese, polemika, publicistikë. Krijues me ndikim në hapësirën kulturore shqiptare. Ka botuar përmbledhjet e tregimeve: “Dritat e mesnatës” (1974), “Vdekja pa emër” (1995), “Portat e qiellit” (1996), “Muri i mjegullës” (1998) dhe “Njëzet tregime për kohën e shkuar” (2001); dramat: “Tri drama” (1988), “Pesë ide për lojë skenike” (1999) dhe “Drama” (2008); pastaj librat publicistikë: “Shoqërimi” (1979), “Vite të humbura” (1995), “Mirupafshim në një luftë tjetër” (2003), “E shtuna ime” (2009), “Identiteti kosovar” (2011); dhe romanet: “Gjurmë në trotuar” (1977), “Portali i perëndive të fyera” (1980), “Moti i Madh” (1981), “Udhëzime për kapërcimin e detit” (1984), “Sëmundja e ëndrrave” (1986), “Net bizantine” (1990), “Edhe të çmendurit fluturojnë” (2004), “Im atë e don-te Adolfin” (2005), “Selvitë e Tivarit” (2007), “Hotel Arbëria” (2010), “E zeza dhe e kuqja” (2015). Cikli i pesë romaneve të përmendur në fund të bibliografisë përbën boshtin kryesor të veprimtarisë romanore të M. Krajës. Ky cikël për bosht qendror narrativ ka temën nga historia shqiptare dhe shtrihet brenda një harku kohor njëshekullor-shekulli i njëzetë. Vizioni krijues i M. Krajës për ngasje frymëzimi ka rrugën historike arbërore, me ngritjet dhe rëniet e saj dhe që janë meritë kryesisht e vetë shqiptarëve, jo e të tjerëve. E veçantë tjetër është se në letërsinë bashkëkohore shqipe kjo vepër është ndër të rrallat që për nga tematika e trajtuar i kapërcen kufijtë mes shqiptarëve dhe i bën bashkë. Hapja e tillë vjen edhe si përplasje, vjen edhe si tërmet dramatik dhe tragjik nganjëherë, por të gjitha këto ndodhin brenda llojit. Edhe në këtë pikë M. Kraja si krijues shquhet për guximin dhe kurajën që sfidon çështje dhe zona nga më delikatet dhe nga më të rëndësishmet për ekzistencën e qenies sonë në hapësirën gjithëshqiptare gjatë njëqindvjetshit të kaluar. Ciklin e pesë romanëve të përmendur do ta përmbyllë me romanin sintezë të kësaj sage shqiptare, “E zeza dhe e kuqja”. Si kurorë e ciklit, romani më i fundit i tij sjell një portret, faktorizon dhe kup-timëson shekullin më dramatik shqiptar. Është laureat i disa çmimeve letrare. (Ali Aliu)

KRAJKU Besnik (1954-). Këngëtar. Lindi në Pejë. Nga viti 1958 jeton në Prizren, ku kreu

shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa Fakultetin Ekonomik e kreu në Prishtinë. Kishte pozita udhëheqëse në Pallatin e Rinisë në Prishtinë dhe në ndërmarrjen “Elan” në Prizren. Hapin e parë në skenën muzikore e bëri më 1972. Ishte fitues i Festivalit “Revia” në Prizren. Më pas u ftua solist në Radio-Prishtinë, ku incizoi shumë këngë, prej të cilave popullaritet të veçantë arriti me “Këngë moj” të M. Piperkut. Më 1973 debutoi në festivalin “Akordet e Kosovës” dhe vazhdoi të marrë pjesë në të gjitha edicionet. Me këngën “Syri i yt ai qiell me shi” të Gj. Kaçinari me tekst të J. Gërvallës mori pjesë në Festivalin e Opatisë. Në garë për këngën e Eurovizionit u radhit ndër këngët e para. Në Festivalin e Opatisë mori pjesë në disa edicione. Bashkëpunoi me kompozitorët K. Lekaj, S. Kajtazi, Gj. Kaçinari, M. Piperku, T. Berisha, B. Shehu etj. (Indira Çipa)

KRAMPTON Riçard (Richard Crampton) (1940-). Profesor dhe studiues britanik, i specializuar në historinë e Europës Lindore dhe atë të Ballkanit në shek. XX. Studimet e larta i kreu në Kolegjin Trinity në Universitetin e Dublinit, ndërsa gradën e doktorit e mori për studime sllave dhe të Europës Lindore në atë të Londrës. Në vitin 1967 nisi karrierën në Universitetin e Kentit në Kanterbyry dhe prej vitit 1996 vijoi në atë të Oksfordit. Është autor i shumë librave, ku përfshihen: “Europa Lindore në shek. XX dhe më pas” (Eastern Europe in the Twentieth Century and After, 1994), “Atlas i Europës Lindore në shek. XX” (Atlas of Eastern Europe in the Twentieth Century), me bashkautor Ben Crampton (1996); “Historia e përmbledhur e Bullgarisë” (A Concise History of Bulgaria, 1997); “Ballkani që prej Luftës së Dytë Botërore” (The Balkans since the Second World War, 2002) etj. Në këto studime, që mbështeten në një bazë të larmishme burimore, R. Krampton trajton me objektivitet historinë e Europës Lindore dhe atë Ballkanit. (Ledia Dushku)

KRAPI Besnik (1986-). Aktor. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi arsimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për aktrim (Baçelor dhe master) në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës luajti në shfaqjet: “Rock’n’Roll” (2010), “Tartufi” (2008), “Macja mbi çatinë e nxehtë” (2010). Luajti edhe në shfaqjet “Sikur kjo të ishte

shfaqje” (Teatri “Oda”, 2012), “Peer Gynti nga Kosova” (Qendra Multimedia, Teatri DeVill dhe Stats Theatre, 2014) etj. Gjithashtu luajti në filmat e metrazhit të gjatë, si: “Babai” (2015), “Ama dorën”(2009) dhe në filmat e metrazhit të shkurtër, si: “Vaska”(2007) “Kulla e Sahatit” (2009), “Kolona” (2012) etj. (Doruntina Basha)

KRASNIQI Adrian (1972-1997). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës. Lindi në Vranoc të Pejës. Më 1993 i ndërpreu studimet dhe kaloi në ilegalitet. Në fillim të viteve ’90 u përfshi në radhët e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Ishte njëri prej luftëtarëve të celulave të para të UÇK-së. Njësi i UÇK-së i udhëhequr prej tij për herë të parë në Kosovë solli dhe vuri në përdorim mortajat antitank (500-she), të cilat u përdorën për herë të parë në shtator të vitit 1997. Ra dëshmor gjatë sulmit të ndërmarrë kundër postëkomandës së policisë serbe në Kličinë të Pejës (16 tetor 1997). Në këtë sulm ishte bashkë me Mujë Krasniqin, Ilir Konushevcin dhe Qerim Kelmendin. Në 12-vjetorin e rënies, në qytetin e Pejës u ngrit shtatorja e A. Krasniqit, ndërsa presidentja e Kosovës e dekoroi me Urdhrin “Hero i Kosovës”. (Fetnete Ramosaj)

KRASNIQI Agron (1978-). Gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme, përfshirë edhe studimet për gazetari dhe komunikime mediale në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1999 është i angazhuar në medie. Punoi në Radio “Rilindja” për një vit, për të kaluar në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) nga viti 2000, ku vazhdon të punojë. Në RTK punoi si gazetar, producent, moderator dhe autor emisionesh. Është moderator edhe në programin e mëngjesit të Televizionit të Kosovës. Në vitin 2012 botoi librin “Debati televiziv”, i cili është libri i parë i kësaj natyre te ne. Ishte botues dhe kryeredaktor edhe i dy revistave me tema sociale e kulturore “Yjet” (1999-2000) “Plus” (2000-2002). (Artan Krasniqi)

KRASNIQI Ahmet (1948-1998). Ushtarak, ministër i Mbrojtjes i Qeverisë së Republikës së Kosovës në mërgim. Lindi në fshatin Zhilivodë të Vushtrrisë. Në vitin 1973 kreu Akademinë Ushtarake në Beograd. Studimet dhe specializimet i vazhdoi në fushën e komandimit dhe të taktikës. Karrierën ushtarake e filloi në



AHMET KRASNIQI

Zagreb, e më pastaj u caktua komandant në Garnizonin e Gospiqit, ku e zë edhe lufta për pavarësinë e Kroacisë. Mbante gradën e kolonelit. Për shkak të aktivitetit të tij në mbështetje të luftës për çlirimin e Kroacisë, u

burgos me akuzën për rrënimin e fuqisë mbrojtëse të Forcave të Armatosura të RSFJ-së. Pas hetimeve të para në Rijekë, u ekstradua në Beograd, prej nga u dërgohet sërish në frontin e luftës. Arrin të ikë sërish dhe përkohësisht strehohet në Kosovë, pastaj kalon në Maqedoni, në Shqipëri dhe prapë kthehet në Kroaci. Ndërkohë, nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mërgim u emërua ministër i Mbrojtjes dhe komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Nis punën për krijimin e kësaj force, por u vra në një atentat në Tiranë më 21 shtator 1998. Është autor i shumë punimeve studimore dhe publicistike, që janë botuar nëpër gazeta dhe revista profesionale. (Besim Myrtezani)

KRASNIQI Arian (1981-). Dramaturg, kritik teatri, skenarist. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për dramaturgjë në Fakultetin e Arteve të



ARIAN KRASNIQI

Universitetit të Prishtinës (UP). Dramat e tij: "Gruaja në kornizë", "Turni i natës", "Gogoli", "Gjashtë", "Bora e kuqe" etj. janë vënë në skenë në teatrot e Prishtinës, të Gjilanit, të Mitrovicës etj. Dramat i ka përmbledhur ose i

ka botuar në libra të veçantë, si: "Dy drama" (2009), "Gjashtë" (botim elektronik, 2013) dhe "Drama" (2014). Është autor i monografisë për Tetarin "Oda", "Oda artistike" (2013). Ka shkruar disa skenarë për filma metrazhesh dhe zhanresh të ndryshme: për filma të shkurtër: "Green Card" (2005), "Sakica" (2006) dhe "Shneta" (2009), si dhe për filmat e metrazhit të gjatë: "Histori maje kulmi" (2015) dhe "Njeriu i dosjeve" (2015). Është fitues i disa çmimeve në vend dhe pjesëmarrës në disa festivale

dhe konferenca ndërkombëtare për dramë dhe teatër. Shkruan kritikë për dramë, teatër dhe film. Që nga viti akademik 2014/15 është ligjërues i angazhuar në Fakultetin e Arteve të UP-së për lëndën dramaturgjë. (Besim Rexhaj)

KRASNIQI Artan (1985-). Sociolog, gazetar. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. U diplomua për sociologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP) (2007). Një kohë punoi mësimdhënës në shkollë të mesme, ndërsa nga viti 2009 punoi në gazetën "Koha ditore", si gazetar për kulturë, ndërsa nga viti 2014 është redaktor në portalin "Koha.net". Është ideator i rubrikës "Monumente" dhe autor i serisë së botimeve "Monumente", që parashihet të botohet në 6 vëllime, dy nga të cilët tashmë janë botuar: "Monument I" (2014) dhe "Monument II" (2015), që përfshijnë trashëgiminë kulturore të Kosovës nga parahistoria deri te Perandoria Osmane. Nga viti 2014 është asistent në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të UP-së. (Ibrahim Berisha)

KRASNIQI Avdyl (1951-). Mjek, kirurg i përgjithshëm dhe abdominal, profesor universitar. Lindi në Vranoc të Pejës. Shkollën fillore e kreu në Baran, ndërsa gjimnazin në Pejë. U



AVDYL KRASNIQI

diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1976). Një kohë punoi si mjek në Klinikë dhe në Dispanserinë e Mjekësisë së Punës në Novobërdë. Specializoi për kirurgji në Zagreb (1982). Deri më 1990 punoi në repartin e kirurgjisë abdominale

në Prishtinë. Magjistroi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoratën e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (2001). Gjatë viteve 1994-1998 punoi si kirurg dhe udhëheqës i poliklinikës private në Pejë, disa muaj gjatë vitit 1998 ishte kirurg në Spitalin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Irzniq, Zona e Dukagjinit. Tani është shef në repartin e kirurgjisë abdominale. Në vitin 2007 ka udhëhequr bordin ekzekutiv të QKUK-së. Në procesin mësimor në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë u angazhua që më 1985, së pari si asistent, pastaj si profesor asistent dhe si profesor i asociuar (2011). Për aftësim profesional

ishite në institucione të njohura jashtë vendit, në Qendrën e Kancerit në Tokio (1986), në Spitalin Universitar në Gjenevë (1994), në Spitalin e Kolegjit Mbretëror në Londër (1999), pastaj në Spitalin Universitar në Ohaio, SHBA (2000) etj. Është autor dhe bashkautor i shumë publikimeve shkencore dhe profesionale. Gjatë periudhës 1991-1993 ishte këshilltar i kryeministrit të Qeverisë së Kosovës në migrim dhe u angazhua në një sërë aktivitetesh politike dhe diplomatike. (Dalip Limani)

KRASNIQI Bajram (1931-2001). Veteran i arsimit. Lindi në Negroc, komuna e Drenasit. Shkollën fillore e kreu në Arllat, shkollën normale në Prishtinë. Punën e mësuesit e filloi në shkollën fillore në Negroc. Ishte mësuesi i parë i kësaj shkolle. Profesionin e mësuesit më pas e ushtroi edhe në shkolla të disa fshatrave të rrethinës së Prizrenit dhe të Rahovecit. Në vitet 1969-1983 punoi si mësues në shkollën fillore “Jeta e re” në Komoran, komuna e Drenasit, ku edhe u pensionua. Krahas punës mësimore Bajram Krasniqi punoi edhe për zhdukjen e analfabetizimit, për emancipimin e femrës fshatare dhe për transformimin kulturor në mjediset shkollore ku punoi. Për punën e bërë mori dekorata dhe mirënjohje. (Islam Krasniqi)

KRASNIQI Bajram (1951-1990). Shkrimtar, studiues i letërsisë, kritik letrar. Lindi në Majac të Podujevës. Kreu shkollimin fillor në shkollën e fshatit dhe në Lluzhan, ndërsa atë të mesëm në Normalen e Prishtinës. Ndoqi studimet universitare dhe pasuniversitare nga fusha e letërsisë në Universitetin e Prishtinës. Aty mbrojti edhe temën e doktoratës. Punoi si mësues dhe mësimdhënës i letërsisë në fshatin e tij, pastaj në gjimnazin e Podujevës, ndërsa nga viti 1975 u zgjodh punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e letërsisë. Një kohë ishte kryeredaktor i revistës “Fjala” dhe redaktor i revistës “Gjurmime albanologjike”.

Veprat e botuara: “Komunikime letrare” (1980), “Letërsia dhe vetëdija historike” (1984), “Poetika e romanit historik shqiptar” (1985), “Kode të ligjërimit letrar” (1988). Në fillimet e krijimtarisë së tij shkroi poezi për fëmijë, të cilat i botoi në revistën “Pionieri” dhe në shtojcën për fëmijë të gazetës “Rilindja”. Konceptet e mendimit dhe të interpretimit të tij letrar

lidhen me interpretimin, historinë, vetëdijen dhe komunikimin. (Kujtim Rrahmani)

KRASNIQI Besnik (1982-). Gazetar. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Drenas, ndërsa studimet për gazetari në Universitetin e Prishtinës. Studioi edhe për mjekësi. Punoi gazetar në të përditshmen “Koha ditore”. Një kohë të shkurtër punoi edhe në të përditshmet “Epoka e re” dhe “Iliria Post”. Bashkëpunoi edhe me gazetatat në Shqipëri e Maqedoni. Për punën e tij u vlerësua dhe u shpërblye nga organizatat vendore e ndërkombëtare me një sërë çmimesh për gazetari hulumtuese. Dy herë u shpall laureat i çmimit “Rexhai Surroi” dhe dy herë nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, pastaj UNDP-ja, GIZ-CDBE etj. Është gazetar-hulumtues në portalin “Insajder”. (Ibrahim Berisha)

KRASNIQI Demir (1950-). Këngëtar popullor, mbledhës folklori. Lindi në Tugjeç të Kamenicës. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë. Një kohë punoi si gazetar radiogazetar dhe gazetar hulumtues. Më pas arsimtar i edukatës muzikore në shkolla fillore dhe të mesme. Ka themeluar grupe dhe ansamble muzikore. Me L. Antonin kanë themeluar Ansamblin vokal-instrumental “Çiftelia” në Radio-Prishtinë. Si këngëtar popullor ishte disa herë përfaqësues i këngës kosovare në Festivalin e folklorit “Danubi i kaltër” (Novi-Sad). Disa vjet me radhë ka marrë pjesë në “Akordet e Kosovës”. Botoi monografinë “Qamili i Vogël - zë që nuk shuhet”. Ka kompozuar dhe incizuar shumë këngë, ka mbledhur këngë e valle folklorike, disa prej të cilave gjinden te “Folklori muzikor shqiptar” (vëllimet IV, V, VI, VII) të L. Antonit. Është nderuar me shumë çmime e mirënjohje. (Arnisa Rexhepi)

KRASNIQI Drita (1950-). Aktore. Lindi në Prishtinë, ku edhe e kreu shkollën fillore dhe të mesme të muzikës. Vijoi studimet e gjuhës frënge në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, kurse u diplomua në Shkollën e Lartë Pedagogjike, në degën e aktrimit. Krahas roleve të saj në skenë, të realizuara kryesisht në Teatrin Popullor Krahinor (TPK), në vitet ’70 dhe ’80 zhvilloi bashkëpunim të dendur edhe me Radio-Prishtinën, ku realizoi një numër të madh rolesh kryesore në radiodrama dhe në emisione të



DRITA KRASNIQI

tjera radiofonike. Luajti në drama televizive dhe në filma artistikë, ndër të cilët veçohet roli i Rozës në filmin “Gjurmët e bardha (1980) në regji të E. Kryeziut. Nga shfaqjet e shumta, ku realizoi kreacione të spikatura në skenë në vitet ’80 në TPK do veçuar: “Dasma e përgjakur”, “Mizantropi”, “Izraelit e Filistinë” etj. Në vitet ’90 realizoi një sërë rolesh, në mesin e të cilave shquhet roli i Laurës në dramën “Babai” (1997), kurse në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XXI u shqua në rolin e Bernarda Albës në dramën “Shtëpia e Bernarda Albës” (2006, TKK). Fitoi një numër të madh çmimesh, në mesin e të cilëve Pllaketën Artë në 30-vjetorin e TPK-së dhe po këtë çmim edhe në 40-vjetorin e këtij institucioni. Në 60 vjetorin e TPK-së, për herë të tretë i është dhënë Pllaketa e Artë, kurse në vitin 2010, nga Teatri Kombëtar i Kosovës i është dhënë Çmimi për Vepër Jetësore. Është nderuar edhe me çmime dhe mirënjohje të tjera. (Besim Rexhaj)

KRASNIQI Faik (1956-). Dizajner dhe piktor. Lindi në Prishtinë. Kreu shkollimin fillor në Prishtinë, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë (1975), ndërsa studimet për dizajn grafik



FAIK KRASNIQI

i mbaroi në Akademinë e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1980). Në vitet 1981-1992 punoi si dizajner në shtypshkronjën “Rilindja”, ndërsa më pas u angazhua si ligjërues në degën e dizajnit grafik të Akademisë së Arteve. Më 2005 u zgjodh profesor i asociuar për lëndën grafika reklamuese. Në fushën e dizajnit grafik përveç përkujdesjes artistike dhe grafike të librit, realizoi logo të kompanive, institucioneve dhe organizatave në Kosovë. Mbahti ekspozita personale dhe mori pjesë në disa ekspozita kolektive, si në Kosovë, Gjermani, Kroaci, Belgjikë, Maqedoni, Shqipëri, SHBA etj. Është fitues i disa çmimeve: “Diploma ‘80”, 1980; Salloni XIV i SHAFK-ut dhe SHAAK-ut, 1987; 15-vjetori i SHAFK-ut dhe SHAAK-ut dhe çmimi për ilustrim, Salloni XXV i Kosovës 1998; çmimi i

tretë në Festivalin e Karikaturës “Kosova 2007” etj. (Zeni Balazhi)

KRASNIQI Fatmir (1956-1999). Mjek, specialist i mjekësisë së punës, dëshmor. Lindi në fshatin Domanek të komunës së Malishevës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Lubizhdë, të mesmen në Kijevë. Studimet i përfundoi në vitin 1982 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Filloi të punonte në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas. Gjatë kësaj kohe mbaroi edhe specializimin nga lëmi i mjekësisë së punës (1987) po në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Shquhej për korrektësi profesionale dhe për marrëdhënie të afërta me pacientët. U vra në prani të familjarëve në Fushë-Kosovë, si përkrrahës i UÇK-së. (Xhevat Shkodra)

KRASNIQI Fejzullah (1953-). Inxhinier i makinerisë, profesor universiteti, akademik. Lindi në Tugjec të Kamenicës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e mbaroi në Prishtinë.

FEJZULLAH
KRASNIQI

Kreu Fakultetin Teknik, seksioni i makinerisë, në Universitetin e Prishtinës (UP) (1977), studimet pasuniversitare në Shkup (1983), ndërsa doktoroi në Prishtinë (1988). Nisi punë si inxhinier në Fabrikën e Qeramikës në Kamenicë (1977), më pas u zgjodh asistent në katedrën e termoenergjetikës dhe termoteknikës në Fakultetin Teknik të UP-së (1979). Në vitin 1989 u avancua docent, pastaj profesor inordinar dhe profesor ordinar për lëndën ngrohja dhe klimatizimi (1999), duke u emëruar titullar i lëndëve: dinamika e proceseve, termodinamika inxhinierike, termocentralet, termofikimi e rrjetet termike dhe analiza e modelimi i sistemeve transportuese. Mbahti cikle ligjëratash edhe në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në Universitetin e Tetovës. Kreu detyra me përgjegjësi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe në organet drejtuese të UP-së: ishte prodekan dhe dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe anëtar i Senatit të UP-së në katër mandate. Në vitin 2008 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), ndërsa në vitin 2012 u zgjodh anëtar i rregullt. Ishte sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut.

F. Krasniqi ka një veprimtari të gjerë shkencore, me një sërë publikimesh në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i shtatë teksteve universitare dhe i tri monografive shkencore: “Ngrohja” (1997), “Ventilimi dhe klimatizimi” (2000), “Termofikimi dhe rrjetet termike” (2010), “Termoelektrocentralet e Kosovës” (2014) etj. Kreu kualifikime shkencore jashtë vendit, si në Rusi, Itali, Gjermani, Austri, Greqi etj. Në vitin 1983, në kuadër të punimit të magjistraturës, kreu projektin e parë të termofikimit të qytetit të Prishtinës nga Termoelektrocentrali “Kosova B” në Obiliq. Ishte koordinatori i parë vendor i projektit ndërkombëtar “Tempus” për “Promovimin e lidhjeve akademike industriale në FIM” (2002-2004). Nga viti 1999 është nënkryetar i Shoqatës Termoteknike të Shqipërisë dhe anëtar i Shoqatës Termoteknike të Italisë. Është bartës i disa mirënjohjeve dhe çmimeve prestigjioze, përfshirë edhe titullin “Doctor Honoris Causa” të Universitetit Politeknik të Tiranës (2015). (Minir Dushi)

KRASNIQI Fehmi (1950-). Inxhinier i makinerisë, profesor universitar. Lindi në Tugjeç të Kamenicës. Shkollën fillore e të mesme i kreu në Prishtinë dhe studimet në Fakultetin



FEHMI KRASNIQI

Nga viti 1974 punoi pandërprerë në Fakultetin Teknik të UP-së, duke u graduar në të gjithë titujt universitarë. Ushtroi funksione të ndryshme në organet drejtuese të UP-së dhe të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Bëri specializime nga fusha e makinerisë në Petersburg, në Moskë, në Vjenë dhe në Atlantë (SHBA). Si autor dhe bashkautor botoi një sërë tekstesh universitare dhe dispensa nga fusha e statikës, kinematikës, dinamikës, informatikës etj. dhe punime shkencore e profesionale. Në ndërmarrje ekonomike kreu shumë projekte nga fusha makinerisë. Ligjëroi edhe në Universitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Europës Juglindore po në Tetovë. (Xhevat Perjuci)

KRASNIQI Feriz (1931-). Botanist, profesor emeritus, akademik. Lindi në Tërpezë të Malishevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Gjimnazin e Ulët e mbaroi në



FERIZ KRASNIQI

Prishtinë, Shkollën Normale në Gjakovë, Shkollën e Lartë Pedagogjike, degën biologji-kimi, e mbaroi në Nish (1954). Diplomoi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Shkupit (1961). Në vitin 1961 u zgjodh asistent për lëndën sistematika e bimëve të larta në katedrën e biologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Tezën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në FSHMN të Universitetit të Beogradit (1968). Ka qenë prorektor (1973-1975) dhe dy mandate rektor i Universitetit të Prishtinës (1975-1979). F.Krasniqi kreu edhe disa funksione shtetërore të nivelit krahinor dhe federativ, si deputet i Dhomës së Kombeve të Kuvendit Federativ dhe anëtar i Kryesisë së Kosovës. Puna e tij kërkimore-shkencore është e orientuar kryesisht në studimin e florës dhe të vegjetacionit. Ka udhëhequr projektin për hulumtimin e florës së Kosovës dhe është themelues i herbariumit të florës së Kosovës në kuadër të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës. Si anëtar i komisionit, mori pjesë në mbrojtjen e disertacioneve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës dhe të Zagrebit. F. Krasniqi ka publikuar shumë punime shkencore dhe ka përshkruar një varg llojesh dhe bashkësish bimore të reja për florën dhe vegjetacionin. Është autor i tekstit universitar “Sistematika filogjenetike e bimëve të larta” dhe i botimit të veçantë “Vegjetacioni i pyjeve të zonës kodrinore të Kosovës”. Është bashkautor i fjalorëve shumëgjuhësh: “Fjalori i emrave të bimëve”, “Fjalori i termave të botanikës” dhe “Fjalori shpjegues i termave të botanikës”. Është bashkautor i fjalorit shumëgjuhësh “Fjalori i barërave të Europës Lindore” (“Dictionary of weeds of Eastern Europe”), botim i Akademisë “Kiado” në Budapest (1987). Për shkollën e afirmimit dhe autoritetit që gëzon në qarqet shkencore lloji i ri bimor i gjinisë *Solenanthus* (*Cynoglossum*) i përshkruar nga botanisti T. Wraber emërtohet me emrin shkencor *Solenanthus* (*Cynoglossum*) *Krasniqi*.

Për kontributin e tij në lëmin e kërkimeve shkencore në procesin arsimor-edukativ në zhvillimin institucional dhe afirmimin e universitetit është dekoruar me shumë çmime dhe mirënjohje. Senati i Universitetit të Prishtinës në vitin 1995, ia ka dhënë titullin “Profesor emeritus” për kontributin e tij në avancimin e Universitetit. Është zgjedhur anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1995) dhe anëtar i rregullt i kësaj Akademie (2000). (Nexhat Daci)

KRASNIQI Haxhi (1928-2002). Mësues, mbledhës folklori. Lindi në Prizren, ku mori arsimin elementar dhe kreu gjimnazin e ulët. Kreu shkollën normale të Gjakovës. Duke filluar nga viti 1950 punoi mësues në Drenoc, në Elezaj të Kaçanikut, Zym të Hasit dhe në Prizren. Për shkaqe politike pushteti jugosllav e mënjanoi nga veprimtaria arsimore. Qysh i ri filloi të angazhohej edhe në jetën kulturore në Prizren, në teatrin amator të qytetit, ndërsa nga viti 1967 u punësua në bibliotekën e Shkollës së Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” në Prizren. H. Krasniqi u mor edhe me mbledhjen e folklorit dhe të leksikut popullor. Botoi tekste të ndryshme në shtypin dhe në botimet e Institutit Albanologjik të Prishtinës. (Sabit Jaha)

KRASNIQI Haxhi (1987-). Boksier. Lindi në Junik. Jeton në Gjermani, ndërsa karrierën në boksion profesionist e nisi në vitin 2005. Është boksier i kategorisë gjysmë të rëndë dhe deri më tash ka 43 fitore e katër humbje. Arriti dy herë të luftojë për titull të botës në boksion profesionist, në dy versione të ndryshme. Humbi luftërat për titull të botës. Ka mbajtur edhe tituj të Europës. Është i vetmi prej boksierëve shqiptarë, i cili dy herë ia ka dalë të luftojë për titullin e botës. Njihet për goditje të fuqishme aperatur dhe për përgatitje fizike. Vlerësohet si boksieri më i mirë shqiptar i të gjitha kohëve. (Tahir Sopi)

KRASNIQI Hysni (1942-). Grafist. Lindi në Llukar të Prishtinës. Kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike, seksioni i arteve figurative, në Prishtinë (1965), ndërsa Akademinë e Arteve Figurative, drejtimin e grafikës, në Beograd (1969). Nga viti 1974 punoi në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku mori titullin profesor i rregullt, duke dhënë kontribut në formimin e gjeneratave të reja të gra-fistëve kosovarë. Lajtmotiv i opusit të tij artistik janë



HYSNI KRASNIQI

portretet e ndryshme nga historia jonë kombëtare, por edhe peizazhet autoktone kosovare. Motivin dhe frymëzimin e tij më së miri e dëshmojnë veprat e cikleve “Portat e vjetra”, “Grunajat”, “Xixëllonjat” etj. Aplikon gamën e teknikave grafike të shtypit të thellë me variacionet e tyre, duke përfshirë dhe mecotintën. H. Krasniqi hapi disa ekspozita personale në Kosovë dhe jashtë saj, si në Podgoricë, Grozhnjan, Beograd, Paris, Nish, Lubjanë, Martini (Zvicër) etj. Mori pjesë në ekspozita kolektive në vend dhe në bienale grafike ndërkombëtare, nga të cilat duhen veçuar shumë mirënjohje e çmime, si në Tuzëll (Bosnjë e Hercegovinë), Mishkoles (Hungari), Bukuresht, Shkup e Manastir, Gjenevë, Zagreb, Paris (medaljoni për grafikë) si dhe disa çmime nga ekspozitat vendore. Është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1965 dhe ka marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë e saj, ndërsa nga viti 1990 është anëtarë i Shoqatës Ndërkombëtare të Artit Plastik. (Basri Mekolli)

KRASNIQI Ipeshkëv Matej (1763-1828). Prift dhe ipeshkëv katolik shqiptar. Lindi në Prizren. Mësimet e para i mori në vendlindje, kurse studimet e larta i kreu në Loreto të Italisë, ku edhe mori titullin e doktorit të shkencave të teologjisë. Pas shtatë vjetësh sedisvakance (periudhë kohore gjatë së cilës selia ishte pa argjipeshkëv), për shkak të vdekjes së argjipeshkëv Matej Mazrekut në Argjipeshkvinë e Shkupit, kur u bënë përpjekje që në mënyra të ndryshme të mbikëqyret funksionimi i saj, më në fund argjipeshkëv i saj, nga papa Piu VII u emërua Matej Krasniqi, në vitin 1816, si argjipeshkëv i parë rezident i Shkupit, në më shumë se 500 vjet të sundimit osman. Imzot M. Krasniqi e udhëhoqi këtë argjipeshkvi 12 vjet në kushte shumë të vështira dhe në kohë të rënda. Vdiq në vitin 1828 në Prizren, ku edhe u varros në kishën e qytetit. (Gjon Berisha)

KRASNIQI Isa (1965-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në fshatin Këpuz të komunës së Klinës. Kreu studimet në Fakultetin Ekonomik

të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1985 u arrestua dhe u dënua me 2 vjet burg për veprimtari ilegale. Pas daljes nga burgu mori pjesë në takimin e këshillit të përgjithshëm të Lëvizjes Popullore të Kosovës të mbajtur më 1993 në lagjen Vranjevc të Prishtinës, ku u mor vendimi për përgatitje për luftë të armatosur. Nën udhëheqjen e tij në fshatin Këpus u formuan celulatat e para ushtarake, ndërsa në vitin 1997 u themelua njësi ushtarak me emrin "Hekuri", që kishte rreth 100 luftëtarë. Ky njësi bënte edhe sigurimin e rrugëve për logjistikë ndërmjet zonave të Drenicës, Pashtrikut dhe Dukagjinit. Pas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për themelimin e Agjencisë së lajmeve "Kosovapress" dhe Radios "Kosova e lirë", I. Krasniqi u emërua përgjegjës për çështje teknike. Ishte pjesë e drejtorisë së informimit në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. (Bedri Muahdri)

KRASNIQI Islam (1942-). Profesor universiteti, pedagog. Lindi në Verbovc, Drenas. Pas shkollës fillore kreu shkollën normale dhe studimet për pedagogji në Fakultetin Filozofik në Prishtinë (1967).



ISLAM KRASNIQI

Magjistroi në Fakultetin Filozofik të Zagrebit dhe doktoroi në shkencat pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1985). Punën profesionale si mësues e filloi në Arllat të Drenasit, pastaj ishte mësimdhënës i lëndëve pedagogjike-psikologjike në Normalen e Ferizajit dhe në Normalen e Prishtinës, në Gjmnazin "Sami Frashëri" të Prishtinës, në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prishtinë dhe në Gjmnazin "Skënderbeu" në Drenas, ndërsa nga viti 1972 punoi si asistent, përkatësisht mësimdhënës, kryesisht, në departamentin e pedagogjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, si dhe në Universitetin e Tetovës dhe në atë të Shkupit. Ushtri detyra me përgjegjësi në institucione të ndryshme, përfshirë edhe dekan i Fakultetit Filozofik, kryetar i këshillit për veprimtari botuese të Universitetit të Prishtinës, anëtar i Këshillit Shtetëror për Hartimin e Kurikulës Parauniversitare të Kosovës etj. Mori pjesë në shumë projekte, simpoziume e konferenca shkencore dhe ishte ligjërues mysafir në disa

universitete. Fusha të interesimit të tij shkencor-profesional janë metodika, didaktika dhe bibliografia pedagogjike shqiptare. Është autor ose bashkautor tekstesh shkollore, universitare dhe të monografive shkencore: "Mësimi i leksimit dhe i shkrimit fillestar" (2002), "Bibliografi e punimeve pedagogjike të botuara në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe midis viteve 1945-1978" (2004), "Një gurrë përherë e freskët e mendimit didaktik në gjuhën shqipe /Periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe midis viteve 1945-1978" (2008) etj. Është bashkautor edhe i abetares mbarëkombëtare. (Naser Zabeli)

KRASNIQI Isuf (1948-). Inxhinier i elektroteknikës, profesor, akademik. Lindi në Prapaçan, komuna e Deçanit. Shkollën e mesme e kreu në Pejë (1968), ndërsa studimet për inxhinieri elektrike në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës (1972).



ISUF KRASNIQI

Në vitin 1973 u zgjodh asistent në Fakultetin Teknik të UP-së. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, ndërsa disertacionin e mbrojti në UP (1987). Në vitet vijuese merr titujt përkatës universitarë, përfshirë edhe titullin profesor ordinar (1998) për lëndët teknika e tensioneve të larta dhe materialet elektroteknike. Në vitin 2008 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa në vitin 2012 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Ligjëroi edhe në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike të Universitetit të Tetovës (1997-1999). U specializua në Qendrën kërkimore-shkencore të Sarajevës (1976), ku kreu analiza nga fusha e ndikimit të ndotjes së mjedisit në punën e pajisjeve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë të montazhit të jashtëm, deri në nivelin 400 kV. Modelon, konstrukton dhe patenton "Motorin elektrostatik-kurorë" (1985), për të cilin mori "Pllakatin e artë për inovacion" (Kroaci, 1985). Në periudhën 1989-1994 ishte dekan i Fakultetit Elektroteknik të UP-së, ndërsa në periudhën 1996-1999 ishte kryetar i Këshillit Qendror të Arsimit të Kosovës. I. Krasniqi është autor dhe bashkautor i disa teksteve universitare dhe për shkollat të mesme teknike ("Teknika e tensioneve të larta", "Materialet elektroteknike" etj.). Në

fushën e kërkimeve shkencore udhëhoqi tema të ndryshme studimi dhe projekte shkencore-hulumtuese e profesionale, ndër të cilat veçohen: “Ndikimi i ndotjes së mjedisit në punën e sistemit elektroenergjetik të Kosovës”, Prishtinë (1975-1977), “Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemin elektroenergjetik të Kosovës” (ASHAK, 2012-2014), “Studimi mbi zhvillimin e prodhimit të energjisë nga biokarburantet” (2013) etj. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore të publikuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Për angazhim në veprimtarinë shkencore mësimore mori çmime dhe mirënjohje. Për dy mandate ishte sekretar shkencor i ASHAK-ut. (Minir Dushi)

KRASNIQI Jakup (1951-). Veprimtar politik, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Negroc të komunës së Drenasit. Kreu Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (1976), ku më pas përfundoi dhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti temën e disertacionit të doktoratës. Në periudhën 1972-1981 punoi si mësimdhënës



JAKUP KRASNIQI

në shkollat e mesme në Drenas dhe Skënderaj. Ishte aktiv edhe në veprimtari politike, në lëvizjen për çlirimin e Kosovës. U burgos në vitin 1981 dhe e dënua me 15 vjet burg. Nga burgu u lirua më 1991, pas shpërbërjes së shtetit jugosllav. Pas daljes nga burgu punoi sërish në gjimnazin “Skënderbeu” në Drenas deri në vitin 1994. Në këtë periudhë zhvilloi aktivitet politik në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Drenas. U zgjodh deputet i LDK-së në Kuvendin e Kosovës më 1992 dhe 1998. Pas daljes në skenë të UÇK-së, u bë zëdhënës i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së (1998-1999), njëkohësisht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe i Drejtorisë Politike të UÇK-së. Ishte anëtar i Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Pas luftës u zgjodh sekretar i përgjithshëm i Partisë Demokratike të Kosovës (1999–2013). Në zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës u zgjodh deputet i PDK-së në Kuvendin e Kosovës (2001) dhe më pas mori detyrën e

ministrit të Shërbimeve Publike (2002-2004). Gjatë negociatave të Vjenës për statusin e Kosovës (2005-2007) ishte anëtar i Grupit Politik Strategjik nga PDK-ja. Në zgjedhjet e dyta parlamentare u zgjodh sërish deputet dhe ishte shef i grupit parlamentar të PDK-së (2004-2007). Në vitin 2007 u zgjodh deputet i legjistraturës së tretë dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës (2008-2014). Nga 28 shtatori 2010 deri më 22 shkurt 2011 ishte ushtrues detyre i presidentit të Kosovës. I pakënaqur me zhvillimet në PDK, u largua nga kjo parti dhe u zgjodh kryetar i Këshillit Kombëtar të partisë “Nisma për Kosovën” (2014), si dhe deputet i kësaj partie në legjislaturën e pestë. Ka botuar një sërë veprash nga fusha e publicistikës dhe e historisë: “Kosova në kontekstin historik” (2005), “Kthesa e madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës” (2006), “Një luftë ndryshe për Kosovën” (2007), “Pavarësia si kompromis” (2010), “Lëvizja për Republikën e Kosovës” (2011), “Një histori e kontestuar” (2013) etj. (Sabit Syla)

KRASNIQI Kushtrim (1982-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studioi për komunikim masiv. Nisi të merret me gazetari sportive, fillimisht në gazetën e sportit “Kosova sport” në vitin 2001, ku punoi deri në vitin 2003. Pas një kohe rifilloi punë në gazetën “Pavarësia News”, pastaj në të përditshëm “Tribuna shqiptare”. Më pas qe kryeredaktor i gazetës “Sport” dhe më vonë kryeredaktor i gazetës tjetër sportive “Sport plus”. Është redaktor i shtojcës sportive “Arena” në të përditshmen “Tribuna”. (Florim Maliqaj)

KRASNIQI Luan (1971-). Boksier. Lindi në Junik. Pas shkollës së mesme, migroi në Gjermani. Nisi karrierën si boksier te ekipi lokal “BSV Rottweil”. Në vitin 1995, pasi mori shtetësinë gjermane, fitoi dy medalje të arta në turnetë e boksit amator të mbajtura në Liverpool dhe Berlin. Një vit më vonë boksoi në Lojërat Olimpikë “Atlanta 1996” dhe arriti të fitojë medaljen e bronzit. Për Gjermaninë kjo ishte medalja e parë olimpikë në boks, prej vitit 1976. Në të njëjtin vit fitoi medaljen e artë në



LUAN KRASNIQI

Kampionatin European të mbajtur në Velje të Danimarkës. Në vitin 1997 u fut në boksion profesionist dhe më 2002 u shpall kampion i Europës në EBU. Gjithashtu fitoi edhe titullin e Gjermanisë të peshave të rënda, si dhe u bë kampion ndërkontinental në vitin 2007. Si profesionist, Krasniqi boksoi deri në vitin 2008. Ka arritur gjithsej 30 fitore, katër humbje dhe një barazim. (Tahir Sopi)

KRASNIQI Mark (1920-2015). Profesor universiteti, etnograf dhe gjeograf, shkrimtar, akademik. Lindi në Gllaviçicë afër Pejës, ku e kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin e mbaroi në



MARK KRASNIQI

Prizren në vitin 1941. Në vitet 1941-1943 studioi letërsinë në Universitetin e Padovës (Itali) dhe më vonë (1946-1950) studioi gjeografinë e etnografinë në Universitetin e Beogradit. Në vitin e parë pas Luftës së Dytë Botërore (1945-

1946) punoi si gazetar-redaktor i gazetës "Rilindja", që dilte në Prizren, kurse më vonë (1947-1949) caktohet të punojë si gazetar-redaktor në Radio-Beograd (Redaksia e emisioneve në gjuhën shqipe). Në vitet 1950-1961 punoi në Institutin Etnografik të Akademisë Serbe të Shkencave në Beograd, si asistent, më vonë me titullin e bashkëpunëtorit shkencor. Doktoroi në Universitetin e Lubjanës në vitin 1960. Në periudhën 1961-1981 ka qenë profesor në Universitetin e Prishtinës, kur pushteti serb e përjashtoi nga procesi mësimor. Ka qenë disa herë prodekan dhe dekan i Fakultetit Juridik-Ekonomik. Në vitin 1979 zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku ka ushtruar funksionin e nënkryetarit dhe të kryetarit. Ishte kryetar i parë i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës (1970) dhe kryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës nga viti 1993 dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka botuar disa libra shkencorë me tematikë gjeoetnografike, antropogjeografike, etnokulturore etj., pastaj libra letrarë, publicistikë dhe tekste shkollore, si dhe ka përkthyer disa romane e përmbledhje poezish nga serbokroatishtja, sllovenishtja dhe maqedonishtja në gjuhën shqipe. Vepra shkencore nga fusha e gjeografisë dhe etnografisë: disertacioni i doktoratës "Ndryshimet bashkëkohore

gjeografike-shoqërore në Kosovë e Dukagjin" (1963), përmbledhje e studimeve etnografike "Gjurmë e gjurmime" (1979), monografitë etnogjeografike "Lugu i Barani" (1985) dhe "Rugova" (1987), përmbledhja e studimeve etnografike "Nga gurra e traditës" (1991) dhe "Aspekte mitologjike-besime e besëtytni" (1997); tekste shkollore dhe universitare me disa botime: "Gjeografia ekonomike", "Gjeografia e Jugosllavisë" etj. Nga fusha e publicistikës ka botuar disa vepra: kompletin prej katër librash "Qëndrime e reagime" (1995), "Mbështetje shkencore 'Përpjekje për Kosovën'" (2001) etj. Nga fusha e letërsisë ka botuar një sërë veprash për fëmijë, si "Përrallat e gjyshit" (1953), "Posta e porositur" (1959), "Lepuri analfabet" (1974), "Postieri i maleve" (1984) etj., vepra që janë ribotuar shumë herë, duke qenë lektyrë shkollore për shumë gjenerata nxënësish të moshave të ndryshme. (Ruzhdi Pllana).

KRASNIQI Metush (1926-1986). Veprimtarë i lëvizjes për çlirimin e Kosovës dhe për bashkim kombëtar. Lindi në Dajkoc të Kamenicës. Shkollën Normale e kreu në Gjakovë, Fakultetin



METUSH KRASNIQI

Juridik në Prishtinë (1976). Punoi si mësues e drejtor shkollë në Rogaçicë të Kamenicës dhe në Studençan të Shkupit, pastaj referent në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë dhe në administratën e Hekurudhave të Kosovës në Fushë-Kosovë. Që nga viti 1944 u përfshi në radhët e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH) dhe ishte bashkëpunëtor i Halim Spahiut, Marije Shllakut e Gjon Serreqit. Më 1950 themeloi organizatën ilegale, e cila u shtri në Anamoravë, Luginë të Preshevës, Kumanovë dhe Shkup. Më 1956 u arrestua, por në mungesë provash u lirua. Më 1958 u arrestua për herë të dytë dhe u dënua me 18 vjet heqje lirie, si udhëheqës i organizatës ilegale. Pas Plenumit të Brionëve (1966) u lirua nga burgu. Vazhdoi veprimtarinë politike për bashkërendimin e forcave atdhetare demokratike për bashkimin kombëtar. Ishte njëri nga frymëzuesit dhe organizatorët e demonstratave të vitit 1968 në Prishtinë dhe në Gjilan. Më 1977 formoi organizatën Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e Viseve

Shqiptare të Jugosllavisë, e cila synonte çlirimin e trojeve shqiptare në Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Organizata shtriu rrjetin në të gjitha hapësirat shqiptare në Jugosllavi. Vuri lidhje me shtetin shqiptar dhe me Lëvizjen Ustashe në Kroaci, e cila ishte shumë e përhapur në SHBA. Ishte njëri nga ideatorët e organizimit të demonstratave të vitit 1981. U arrestua dhe u mbajt në izolim 8 muaj në burgun e Gjilanit. Më 1982, me insistimin e tij, u bashkuan në një lëvizje të vetme të gjitha grupet ilegale që vepronin në hapësirat shqiptare në Jugosllavi. Ishte antikomunist i përbetuar, por bashkëpunoi me të gjitha rrymimet politike për interes të bashkimit kombëtar. Për herë të fundit u arrestua në nëntor 1985. Nuk e dorëzoi rrjetin bashkëpunëtorëve të tij, që ishin mbi 500, ndonëse u torturua egërsisht 6 muaj radhazi, derisa u konstatua se do të vdiste. Për qëndrimin e tij të pamposhtur në hetime, në burgje e në veprimtari nga bashkëveprimtarët u quajt "Legjenda e qëndresës shqiptare". (Fehmi Rexhepi)

KRASNIQI Milaim (1969-). Gazetar i sportit. Lindi në Makoc të Prishtinës. Studioi për gazetari dhe komunikim. Punën e gazetarit të sportit e filloi në gazetën "Bujku" në vitet '90, ndërsa më vonë punoi në Radion "Rilindja" dhe Radion "Kosova e lirë". Punoi edhe në televizionin TV "AA", si prezentes i emisioneve të ndryshme. Në vitin 2001 zë punë në Radio-Kosovë, ku vazhdon të punojë ende. Gjatë kësaj periudhe ka komentuar afro 2 mijë ndeshje të futbollit nga vendi i ngjarjes. Është redaktor përgjegjës i programit sportiv në këtë radio dhe kryetar i Shoqatës së Gazetarëve Sportivë të Kosovës. (Florim Maliqaj)

KRASNIQI Milazim (1955). Poet, prozator, dramaturg, publicist. Lindi në Breznicë të Prishtinës. Kreu shkollimin fillor në vendlindje, shkollën e mesme në Prishtinë dhe studimet për letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik po në Prishtinë (1980). Vioi dhe kreu studimet pasuniversitare, më pas kreu doktoratën (2004) me temë për format e sonetit në poezinë shqipe. Profesor i gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, M. Krasniqi është themelues i Institutit të Medies, pastaj redaktori i parë i zhurnalit "Media". Për disa vjet ishte anëtar i këshillit drejtues të Radiotelevizionit të Kosovës dhe më pas anëtar



MILAZIM KRASNIQI

i këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës. Gjatë viteve '80 ka qenë kryeredaktor i revistës "Fjala" dhe sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Ishte njëri ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Deri më tani ka shkruar një sërë veprash autoriale në poezi, prozë, dramë dhe studime letrare. Vepra poetike të botuara: "Imazhi gri" (1982), "Pirg vegimi" (1985), "Qeshje sardonike" (1987), "Formula e Katonit" (1990), "Kurs për pantomimë" (1994), "Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat" (1996), "Dritë në kujtime" (2008), "Rigetja e vetes" (2013). Vepra në prozë: "Fijet e shpirtit" (1998), "Fotografitë e kujtimeve" (2002). Ka shkruar disa komedi, si dhe dramat: "Bryma e vdekjes" (2001), "Kosovë në ndërgjegje" (2001), "Monedha e Gentit" (2003). Poezinë e M. Krasniqit e shquan mbizotërimi i figurës së paradoksit, ironisë dhe diskursi i risemantizimit të simboleve etnike-nacionale. Është autor i tekstit universitar "Hyrje në gazetari" (2008) dhe i studimit "Letërsia dhe besimet fetare" (2010), "Poezia dhe vdekja" (2016). Shkruan tekste të shumta si komentues politik në mediumet e Kosovës. (Nysret Krasniqi)

KRASNIQI Mirsad (1960-). Fotoreporter i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm, si dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike. Pati një karrierë të suksesshme si fotoreporter i sportit, fillimisht në revistën "Refleksi sportive", pastaj në gazetën "Sport plus". Pas përfundimit të luftës në Kosovë, punoi në të përditshmen "Rilindja". Bashkëpunoi edhe me gazetën "Koha ditore", kurse në periudhën 2001-2005 u angazhua në gazetën javore sportive "Kosova sport". Gjatë viteve 2006-2010 punoi në të përditshmen "Infopress", njëkohësisht edhe në të përditshmen sportive "Sport". (Besim Kajtazi)

KRASNIQI Muhamed (1955-). Gazetar, poet. Lindi në Tugjec të Gollakut. Shkollimin fillor e kreu në Miradi të Fushë-Kosovës, kurse gjimnazin në Prishtinë. Studioi për gazetari në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Më 1976 filloi punën e gazetarit në revistën javore "Zëri i rinisë", ku më pas punoi redaktor

i rubrikës së brendshme politike. Në vitet 1982-1986 ishte kryeredaktori i kësaj reviste. Në vitet 1982/83 ishte kryetar i Konferencës së Rinisë Socialiste të Kosovës. Në vitet 1987-89 punoi në organizatat shoqërore-politike të komunës së Prishtinës, ndërsa më 1989 u shkarkua nga detyra për shkak të kundërvënies dhe suprimimit të autonomisë së Kosovës. Në fillim të viteve '90 ishte kryetar i degës së Prishtinës të Partisë Shqiptare Demokristiane. Në periudhën 1989-1998 punoi gazetar në të përditshmen "Rilindja". Më 1998 emigroi në Suedi. Është autor i librave me poezi "Sharkia e vitit" (2000), "Unë jam ABC-ja" (2001), "Gjerdani i Pavarësisë" (2008) dhe bashkautor i librit "Gjurmë shqiptare në Suedi" (2013). Në Suedi punoi si reporter në programin në gjuhën shqipe të Radio Suedisë dhe më pas si ndihmësmësues në Celsiusskolan të Upsalës. (Artan Krasniqi)

KRASNIQI Mujë (1967-1998). Pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hero i Kosovës, i njohur si komandant "Kapuçi". Lindi në fshatin Qabiq të komunës së Klinës.



MUJË KRASNIQI

Në vitin 1994 u arrestua, më pas kaloi në ilegalitet. Mbante kontakte me udhëheqësit kryesorë të UÇK-së, me të cilët kohë pas kohe edhe kryente aksione të organizuara kundër postave policore dhe postblloqeve të policisë. Më 28 nëntor të vitit 1997, me rastin e varrimit të dëshmorit Halit Geci nga Llausha, M. Krasniqi, së bashku me Daut Haradinajn dhe Rexhep Selimin, dolën publikisht para mijëra qytetarëve, ku shpalosën synimet e UÇK-së. Ishte iniciator i formimit të njësitit luftarak "Alfa" të UÇK-së. Më 16 prill të vitit 1998 M. Krasniqi u plagos rëndë dhe më pas u dërgua për shërim në Shqipëri. Në nëntor të vitit 1998 me bashkëluftëtarë depërtoi me sukses në Shqipëri, për të marrë armatim dhe municion për nevojat e luftës. Më 13-14 dhjetor 1998, me 143 luftëtarë të UÇK-së u nis për në Kosovë dhe në Pashtrik, në relacionin Likenet e Hasit-Gorozhup, forcat serbe godasin kolonën, me ç'rast vritet M. Krasniqi dhe mbi 30 bashkëluftëtarë të tij. Më 21 dhjetor të vitit 1998, M. Krasniqi dhe 35 dëshmorë të tjerë u varrosën me nderime ushtarake në Polac të

Drenicës. Në nderim të veprës së M. Krasniqit, Brigada 113 e Drenicës mori emrin e tij. Në vitin 2009 presidenti i Kosovës i ndau Urdhrin "Hero i Kosovës". (Sylë Ukshini)

KRASNIQI Naim (1960-). Klarinetist, kompozitor këngësh për pionierë, i muzikës së lehtë dhe këngësh në frymën e melosit popullor. Lindi në Drenoc. Kreu Shkollën e Mesme të Muzikës, drejtimi klarinetë më 1979, ndërsa Fakultetin e Arteve më 1984. Në vitet 1982-1990 ishte anëtar i Korit të Radiotelevizionit të Prishtinës. Ndërkohë themeloi Oktetin "Prishtina", inicizoi këngë të traditës arbëreshe dhe i realizoi në koncerte. Pas deinstitutionalizimit të jetës në Kosovë themeloi produksionin "Polifonia", nën ombrellën e të cilit u organizuan festivalet "Kënga jonë", "Polifest" etj. Disa këngë të tij për pionierë konsiderohen "hitë". Fitues i tri "Okarinave të arta" në "Akordet e Kosovës", katër herë fitues i "Zambakut të argjenditë" dhe i "Mikrofonit të artë". Vite me radhë ka marrë pjesë në Festivalin e Këngës në Radiotelevizionin Shqiptar. Është autor dhe realizues i muzikës për shfaqje teatrale dhe filma. Shquhet me ndjesinë e veçantë ndaj mjuziklit për pionierë, autor skenari, regjie e realizimi për pesë të tillë në Radiotelevizionin 21, ku vepron dhe sot. Ndër këngët që mbeten të pranishme me vite janë: "Loti nëpër faqe", "Këngë për Vaçe Zelën", "Simpatia", "Lena" etj. (Sami Piraj)

KRASNIQI Nehat (1956-). Orientalist, osmanolog. Lindi në Brezne të Dragashit. Kreu studimet në Universitetin e Prishtinës (UP), në degën e orientalistikës të Fakultetit të



NEHAT KRASNIQI

Filologjisë. Specializoi për gjuhë dhe paleografi osmane në Universitetin e Stambollit dhe u doktorua në shkencat historike në UP. Gjatë viteve 1980-1983 punoi si bibliotekar-bibliograf në Bibliotekën Përkujtimore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prizren, ndërsa në vitet 1984-1990 dhe më pas në periudhën 1999-2014 punoi si arkeograf në departamentin e koleksioneve të veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Nga viti 1996 është pedagog i jashtëm në UP për lëndët gjuhë dhe paleografi osmane dhe nga viti 2011

edhe në Universitetin e Prizrenit. Është autor i përmbledhjes studimore “Kontribute albanologjike: (studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane)” (2011), i monografisë “Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare” (2015) dhe i një sërë artikujsh shkencorë, të botuar brenda dhe jashtë vendit. Aktualisht është bashkëpunëtor shkencor për periudhën osmane në Institutin Albanologjik të Prishtinës. (Nuridin Ahmeti)

KRASNIQI Nexhat (1952-). Dizajner, karikatunist. Lindi në Pejë. Kreu studimet për grafikë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Specializoi për dizajn grafik dhe film



të animuar në Zagreb. Punoi si karikatunist në të përditshmen “Rilindja” (1976-1989). Organizoi dhe drejtoi Festivalin e karikatursë “Kosova award”. Bashkëpunoi me gazeta të përditshme e revista dhe punën e tij krijuese e paraqiti në

NEXHAT KRASNIQI

një sërë ekspozitash personale dhe kolektive në vendet e rajonit, në disa shtete të Europës, pastaj në SHBA, Kubë, Meksikë, Argjentinë etj. Realizoi një numër të madh dizajnimesh grafike për kompani private dhe shtetërore në Kosovë dhe Shqipëri. Është autor i disa filmave të shkurtër të animuar dhe i spoteve televizive. Është autor i logove të disa institucioneve dhe partive politike në Kosovë dhe i pllakateve të zgjedhjeve etj. Për karikatursë mori disa çmime (pllakatin “Dita e rinisë ’78”, Prishtinë dhe më 1979 në Tolentino të Italisë, çmimin special). Gjatë viteve 1981-2008 mori një sërë çmimesh me rastin e ekspozitave në qendra të ndryshme të botës, ndër të cilët edhe çmimin “Necati Abaci” për karikatursë në Shtutgart (2008). Më 2014 hapi ekspozitën retrospektive në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë. Është anëtar i disa asociacioneve ndërkombëtare të karikatursës në Gjermani, Itali, Belgjikë, SHBA etj. (Zeni Balazhi)

KRASNIQI Nysret (1976-). Studiues i letërsisë, profesor universiteti. Lindi në Prishtinë, ku kreu gjimnazin dhe Fakultetin e Filologjisë (2001). Po në këtë fakultet kreu studimet pasuniversitare dhe doktoraturën (2009). Në

periudhën 1999-2005 ishte redaktor i kulturës në disa revista dhe gazeta të Kosovës, ndërsa nga viti 2006 është mësimdhënës në degën e letërsisë shqipe të Fakultetit të Filologjisë. Ka marrë pjesë në konferenca shkencore dhe ka botuar një numër tekstesh studimore. Nga monografitë e tij studimore veçojmë: “Libri i Pashkut” (2005), “Udha kratilike” (2008), “Autori në letërsi” (2009), “Epistemë letrare” (2010), “Sabri Hamiti” (2011), “Harta letrare” (2014), “Letërsia e Kosovës, 1953-2000” (2016), etj. Shquhet edhe për përkthimin e studimeve të autorëve perëndimorë, të cilat i botoi në veprën “Teori dhe kritikë moderne” (2008). Për vlerën e studimeve të tij, u nderua me çmimin “Azem Shkreli” në vitin 2009. Aplikimi i teorive moderne filozofike-letrare në tekste letrare dhe studimi sistematik i tyre bëjnë që ai të shquhet për analizën tekstuale, hermeneutike dhe filozofike të letërsisë shqipe, në përfaqje edhe me letërsitë e huaja. Së fundi merret me hulumtime historike-letrare në letërsinë e Kosovës. (Zejnullah Rrahmani)

KRASNIQI Ramiz (1924-1980). Mjek, gjinekolog-obstetër. Lindi në Prishtinë. Shkollimin fillor e kreu në Prizren, të mesmen në Prishtinë. Fillimisht punoi si mësues në Opojë dhe më pas u transferua në Ferizaj (1944-1945). Në vitin 1947 u arrestua nga OZN-a. Pas lirimit nga burgu, u zhvendos në Sarajevë dhe atje e kreu Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Sarajevës. Pas përfundimit të studimeve punoi si mjek në Ilixha afër Sarajevës. Në vitin 1957 u kthye në Prizren, ku u punësua në QRM të Prizrenit. Kishte bërë specializimin në gjinekologji me akusherë. Ishte gjinekologu i parë shqiptar i rajonit të Prizrenit. Punoi si mjek gjinekolog dhe obstetër për vite të tëra, duke dhënë kontribut të çmuar në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të nënës dhe foshnjave në rajonin e Prizrenit. Publikoi disa punime profesionale në revista shkencore në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Ishte aktivist i dalluar i Kryqit të Kuq të Kosovës, i dekoruar me medalje të artë. (Sejdullah Hoxha)

KRASNIQI Ramiz (1958-). Futbollist, trajner. Lindi në Novi Pazar. Më pas, së bashku me familjen, kalon për të jetuar në Prishtinë. Karrierën prej futbollisti e nisi që herët. Në vitin 1962 bëhet pjesë e “Flamurtarit” të Prishtinës. Pas një kohe luajti për “Kosovën” e

Obiliqit dhe më vonë nënshkruan kontratë me "Partizanin" e Beogradit. Në vitin 1980 kthehet në KF "Prishtina", ku bëhet pjesë e "brezit të artë". Në KF "Prishtina" luajti deri në vitin 1987, pastaj kalon te KNI "Ramiz Sadiku"; karrierën aktive e mbyll te KF "Flamurtari (1992). Ka bërë karrierë edhe si trajner, një kohë te "Flamurtari" dhe më vonë te KF "Prishtina", ku ishte trajner i grupmohave të reja, por edhe i skuadrës së parë, gjatë periudhës 1999-2011. Një kohë drejtoi edhe "Ferronikelin" e Drenasit, me të cilin fitoi Kupën e Kosovës për stinorin 2013/14. Është përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës U-19. (Ejup Lumnica)

KRASNIQI Rashit (1932-). Gazetar. Enigmati i parë në Kosovë. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore, të mesmen dhe Fakultetin Juridik i kreu po në Prishtinë. Që nga viti 1949 ishte anëtar i Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare, më vonë i Ballit Kombëtar. Më 1951, për gjashtë muaj, punoi në revistën "Zani i rinisë", më pas mësues dhe pastaj arsimtar i matematikës dhe i muzikës në gjimnazin e Prishtinës. Fjalëkryqin e parë e botoi më 1953 në "Rilindje". Në mars të vitit 1956 arrestohet dhe vuan tri vjet burg. Pas burgut fillon punë në "Rilindje", si enigmat, ndërsa më vonë edhe si kritik muzike. Në "Akordet e Kosovës" më 1960 dhe 1961 zë vendin e parë në konkurrencën për këngë argëtuese dhe atë për fëmijë. Më 31 mars të vitit 1981 përjashtohet nga puna për shkak të fjalëkryqit të tij, të cilësuar si nxitës i demonstratave të studentëve. Më pas u mor me zdruckhtari artistike. Është autor i shumë eseve dhe kritikave për muzikën dhe i librave politikë dhe letrarë ("Përjetime të lehta", "Me sekretet në varr"). (Zenun Çelaj)

KRASNIQI Sadik (1955-). Mësimdhënës universitar, zhytës dhe instruktor i skijimit. Lindi në Begaj të komunës së Vushtrrisë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, Shkollën e Lartë Pedagogjike për edukatë fizike e kreu në Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Kulturës Fizike në Sarajevë. Studimet pasuniversitare i kreu në Novi-Sad, ndërsa temën e disertacionit të doktoratës e mbrojti në Institutin e Kulturës Fizike "Vojo Kushi" në Tiranë (1998). Është i kualifikuar në nivel ndërkombëtar si zhytës dhe instruktor i skijimit, ndërsa është autor i krijimeve profesionale në gjimnastikë dhe koreografi.

Që nga viti 1980 nis me punë në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë si asistent dhe më pastaj si ligjërues për lëndët e vallëzimit dhe të gjimnastikës ritmike sportive. (Albatrit Matoshi)

KRASNIQI Salih e Feriz. Rapsodë popullore. Salih Krasniqi (1918-1987) lindi në Llashkadrenoc të Malishevës. Rrjedh nga një familje me traditë rapsodësh. Sadik Laci, gjyshi dhe babai, Bajram Sadiku, ishin rapsodë të njohur. Salihu ishte autodidakt që filloi të këndojë qysh në moshën 7-vjeçare. Feriz Krasniqi (1924-1999) lindi po në fshatin Llashkadrenoc. Filloi të këndonte në moshën 12-vjeçare. Që nga viti 1944, Salih e Feriz Krasniqi kënduan së bashku dhe nuk u ndanë kurrë nga kënga. Këngët e interpretuara nga ata shënojnë një kapitull më vete në folklorin burimor të Kosovës. Pjesa më e madhe e repertorit të tyre ishin krijime të vjetra të traditës folklorike. Morën pjesë dhe shpesh edhe u shpërblyen me çmime të para në shumë festivale folklorike. Në vitin 1966 ata morën pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Folklorit në Longolen të Anglisë, ku me interpretimin e këngës "Lulëzoi fusha, lulëzoi mali" fituan çmimin e parë. Pjesa më e madhe e repertorit të këngëve historike të Salih e Feriz Krasniqi është botuar në dy vëllime me titull "Këngë popullore", përgatitur nga rapsodi Muharrem Gashi. (Adem Zejnullahu)

KRASNIQI Selim (1936-). Mjek gjinekolog-obstetër, profesor universitar. Lindi në Tërpezë të Malishevës, shkollën fillore e kreu në Carallukë të Klinës, ndërsa gjimnazin në Prizren. Studimet i kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Shkupit (1962). Një kohë punoi si mjek në komunën e Drenasit dhe ishte mjeku i parë shqiptar i kësaj komune. Specializimin nga gjinekologjia me obstetrikë



SELIM KRASNIQI

e kreu në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Beogradit. Më 1964 kaloi me punë në Spitalin e Përgjithshëm në Prishtinë, në repartin e gjinekologjisë, më vonë në Klinikën e Gjinekologjisë në Prishtinë. Në 1974 u zgjodh asistent i gjinekologjisë me obstetrikë në

Fakultetin e Mjekësisë, më 1985 mbrojti temën e doktoratës dhe mori titullin profesor inordinar i kësaj lënde. Ishte shef i katedrës, shef i repartit dhe udhëheqës i specializimeve për gjinekologji. Në vitin 1990 u largua me dhunë nga Klinika dhe nga Fakulteti i Mjekësisë, ndërkohë e hapi poliklinikën private, në të cilën bënë punë praktike studentët e mjekësisë. Punoi me vite në shërbimin gjinekologjik “Nënë Tereza”, tërësisht në baza vullnetare. Ka botuar një sërë punimesh shkencore, si autor dhe bashkautor. (Sejdullah Hoxha)

KRASNIQI Selim (1970-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Drenoc të Malishevës. U burgos që kur ishte nxënës i shkollës së mesme. Në vitet '90 emigroi në Zvicër, më pas u kthye në Shqipëri dhe së fundi në Gjermani, ku u përfshi në aktivitetet e Lëvizjes Popullore të Kosovës. Në vitin 1997 u kthye në Kosovë me bashkëluftëtarë të tjerë për t'i përforcuar radhët e UÇK-së. Mori pjesë në luftë kundër forcave serbe që në maj të vitit 1997, ndërsa në vitin 1998 dhe më pas u angazhua në shumë aksione luftarake deri në përfundim të luftës. Pas luftës u angazhua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, me gradën gjeneral brigade, me detyrën e komandantit të Zonës së Dytë Mbrojtëse në Prizren. Në shkurt të vitit 2004 u arrestua nga UNMIK-u me akuzën për krime lufte. U mbajt në burg, për t'u liruar pas 3 vjetësh e gjysmë si i pafajshëm. Dhjetë ditë pas lirimit u lëshua sërish një fletarrest kundër tij, duke vazhduar kështu si i përndjekur dhe i burgosur deri në vitin 2015. (Selvete Krasniqi)

KRASNIQI Sulejman (1937-2011). Shkrimtar. Ka lindur në Hoçë të Vogël të Rahovecit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prizren. Pasi burgoset, qëkur ishte nxënës u arratis në Shqipëri. Një kohë jetoi në vendqëndrimin e emigrantëve në Llakatund të Vlorës, pastaj u internua në Seman të Fierit dhe në Levan të Fierit. Më pas punoi si llogaritar në Berat, kurse në vitet 1963-1967 kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Pas kryerjes së studimeve punoi si mësues në shkollë të mesme në Mat dhe në Tiranë deri në vitin 1982, kur u bë shkrimtar me profesion të lirë. Në shtypin periodik ka shkruar skica, tregime,

artikuj, reportazhe, pamflete etj. Romanin e parë e shkroi kur ishte mësues në Klos të Matit. Më pas botoi shumë vepra, romane, novela, pjesë teatrale etj. Disa nga veprat e botuara janë: “Tri motra, tri histori” (1972), “Në shpellën e banditëve” (1973), “Qielli i përflakur” (1974), “Prijësja e komitëve” (1975), “Mic Sokoli” (1979), “Pushka top Bajram Curri” (1982), “Dardanët” (1985), “Oso Kuka” (1990), “Rapsodia e kosovares” (2001), “Rebeli i bajraqeve” (2010), pastaj librat publicistikë “Shqiptarofobia e serbomëdhenjve” (1990) dhe “Evropë deri kur do të keqpërdorësh durimin e Kosovës shqiptare” (1997). Ishte laureuar me Çmimin e Republikës dhe u dekorua me Urdhrin e Punës nga Kuvendi i Shqipërisë. U kthye për herë të parë në Kosovë pas luftës së fundit. Vdiq në Tiranë. (Shaip Beqiri)

KRASNIQI Shaip (1944-2000). Shkrimtar. Lindi në fshatin Laçiq të Kamenicës. Kreu shkollën fillore në vendlindje, të mesmen në Gjiilan, ndërsa studimet për drejtësi në Universitetin e Prishtinës. Punoi si jurist në Gjiilan dhe në Prishtinë. Me krijimtari letrare u mor qysh si nxënës i shkollës së mesme. Nga fillimi i viteve shtatëdhjetë ishte i pranishëm në periodikun letrar, sidomos në revistat “Fjala” dhe “Jeta e re”. Në periudhën 1994-2001 botoi shtatë vëllime me poezi; “Gjëmim shkrepush” (1994), “Dasma e kafkave” (1996), “Anatokë, anatokë” (1997), “Kozmike” (1997), “Tokëjona” (1998), “Grykë” (1998), “Mezomes” (2001). (Hasan Hasani)

KRASNIQI Shemsi (1961-). Sociolog, mësues-dhënës universitar. Lindi në Prishtinë, ku mbaroi shkollimin fillor dhe të mesëm. Kreu studimet në vitin 1985 në katedrën filozofisociologji të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet pasuniversitare i bëri për etnologji në Universitetin e Strasburgut në Francë (2007). Në po të njëjtin universitet, më 2013, i mbaroi edhe studimet e doktoratës. Është mësues-dhënës në departamentin e sociologjisë të Fakultetit Filozofik të UP-së dhe ligjëron lëndët nga fusha e kulturës, artit, mjedisit dhe metodave të hulumtimit. Është autor i dy teksteve shkollorë për edukatën qytetare, i disa punimeve shkencore dhe i shkrimeve esistike dhe publicistike me tematikë sociale dhe kulturore. Ka realizuar disa hulumtime empirike, që kanë të bëjnë kryesisht me kujtesën

kolektive dhe me ndryshimet sociokulturore në Kosovë. Gjithashtu ka marrë pjesë në një numër konferencash dhe kongresesh ndërkombëtare, në fushën e shkencave shoqërore dhe humanistike. Është autor i librit “Natyra në kulturën shqiptare - refleksione mbi një ekokulturë” dhe “Ekokultura”. (Ardian Gola)

KRASNIQI Shpatmal (1985-). Gazetar i sportit. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Filloi punën si gazetar në të përditshmen sportive “Sport” në vitin 2009, ku punoi deri në vitin 2013. Pas hapjes së gazetës “Sport plus” u angazhua si redaktor i sportit vendor dhe punoi deri në verë të vitit 2014. Po këtë detyrë e kreu edhe në gazetën sportive “Arena”. (Florim Maliqaj)

KRASNIQI Teuta (1981-). Aktore. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Kreu studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës



TEUTA KRASNIQI

(2004). Është njëra ndër aktoret më të angazhuara të gjeneratës së re. Ka realizuar një sërë rolesh në shfaqje teatrore në Teatrin Kombëtar të Kosovës: “Të mallkuarit” (2003), “Nora” (2012), “Gishti” (2015). Në po këtë teatër ka luajtur edhe në shfaqjen “Një burrë mes dy grash” (2015). Në vitin 2012 ka interpretuar në shfaqjen “Darka private” në Teatrin e Pejës. Në vitin 2015 mori çmimin vjetor për aktoren më të mirë nga Ministria e Kulturës për rolin e Shkurtës në shfaqjen “Gishit”. Njihet edhe si aktore e filmit, dramave dhe serialve televizive. Për shumë vjet është identifikuar me rolin e Sarandës në serialin e popullarizuar “Kafeneja jonë”. Ka luajtur në filmin artistik të metrazhit të gjatë “Engjëjt janë larg” (2016) me regji të Gjergj Xhuvanit. (Besim Rexhaj)

KRASNIQI Xhafer (1943-2009). Gazetar. Lindi në Vranoc të Pejës. Shkollën fillore e mbaroi në Baran, ndërsa gjimnazin në Pejë. Më pas mbaroi studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1971). Punoi dy vjet lektor në gazetën “Rilindja”, ndërsa më 1974 filloi punë si gazetar-redaktor në redaksinë e kulturës të Televizionit të Pristi-

nës (TVP). Ishte drejtues i emisionit “Spektri”, ku trajtoheshin tema nga fusha e kulturës, letërsisë dhe arteve. Pas demonstratave të vitit 1981 i ndalua puna si gazetar. Punoi lektor në TVP deri në mbyllje të tij nga Serbia më 1990. Në vitin 1991 filloi punën si korrespondent nga Prishtina i gazetës shqiptaro-amerikane “Illyria” në Nju-Jork. Tri vjet më vonë iu bashkua stafit redaktues të kësaj gazete në Nju-Jork, ku punoi deri në fund të vitit 1998. Vdiq dhe u varros në Nju-Jork. (Ibrahim Berisha)

KRASNIQI-DANI Ramadan (1958). Këngëtar. Lindi në Pejë ku kreu shkollimin fillor e të mesëm. Karrierën si këngëtar e filloi me orkestrën “Vëllezërit Bakraçi”, ndërsa paraqitjen e parë si solokëngëtar e realizoi rreth viteve 1973/74. Është i njohur në vend si këngëtar i muzikës popullore dhe argëtuese. Ka një numër këngësh të përmbledhura në mbi 30 albume muzikore. Ka marrë pjesë në koncerte, manifestime dhe festivale të ndryshme muzikore. Në shumë prej tyre është shpërblyer me çmime të ndryshme. (Kristina Palokaj-Perkola)

KRASNIQI-HOXHA Selvete (1953-). Mjeko, ekologe humane, profesore universiteti. Lindi në Kaçanik, shkollimin e kreu në Prishtinë. Mbaroi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1978). Pas diplomimit u punësua në Institutin e Higjienës të Entin për Mbrojtje Shëndetësore të Kosovës. Specializimin në lëmin e higjienës e vijoi në Prishtinë dhe në Zagreb. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1988). Në vitin 1985 u emërua asistente për lëndën e higjienës. Në vitin 1991 u largua me dhunë nga puna dhe për një kohë qëndroi në Gjermani, Tiranë dhe Londër. Tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1995) dhe u emërua docente për lëndën e higjienës. Në vitin 2000-2001 ishte këshilltare e lartë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për normativat dhe cilësinë e ujit të pijshëm për Kosovë. Kreu detyra me përgjegjësi në institucionet shëndetësore dhe arsimore të Kosovës. Për perfeksionim profesional qëndroi në Jordani, Kroaci, Britani të Madhe, SHBA etj. Mban titullin profesor i rregullt i lëndës së higjienës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Është bashkautore e dy teksteve universitare, ka të botuar një sërë punimesh profesionale dhe ka marrë pjesë në

disa kongrese dhe simpoziume ndërkombëtare (Gjyle Mulliqi)

KRASHNICA Abdullah (1917-1945). Pjesëtar i lëvizjes antifashiste. Lindi në Preshevë. Që në moshë të re u pranua në radhët e Rinisë Komuniste të Jugosllavisë dhe më 1940 u zgj-



ABDULLAH
KRASHNICA

odh sekretar i Komitetit Lokal të PKJ-së për Preshevë. Themeloi klubin sportiv "Karadaku" dhe shoqërinë kulturo-artistike të qytetit, ku aderimin të rinj me ide progresive. Më 1941, me pushtimin bullgar të këtyre trevave, u përfshi në

lëvizjen antifashiste. U arrestua nga autoritetet bullgare, por më pas u arratis nga burgu dhe u vendos në Gjilan, në zonën e pushtuar nga Italia. U zgjodh sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së dhe më 1943 u burgos nga italianët. Pas kapitullimit të Italisë, iu bashkua njësiteve partizane të Kosovës. Më 1944 u ngarkua me detyrën e sekretarit të Komitetit të PKJ-së për rrethin e Preshevës dhe në korrik 1944 u zgjodh anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Maqedonisë (ASNOM). Mori pjesë në Kuvendin e ASNOM-it, që u mbajt në Manastirin Prohor Pčinjski. Me hyrjen e njësiteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë (UNÇJ) në Preshevë e rrethinë, në fund të vitit 1944 e në fillim të vitit 1945, u angazhua në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve të kësaj treve nga keqpërdorimet e pushtetit që kryenin disa nga njësitet partizane të UNÇJ-së, duke ndërhyrë edhe në lirimin e shqiptarëve të pafajshëm nga burgjet. Vdiq në spitalin e Shkupit. Dyshohet se u helmua. (Fehmi Rexhepi)

KRASHNICA Dërgut Abdullah (1939-). Aktivist politik në Preshevë, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa në Leskocv kreu shkollën e lartë të tregtisë. Në vitin 1974 u zgjodh sekretar i komitetit komunal në Preshevë. Zhvillimet politike pas demonstratave të vitit 1981 bënë që të jep dorëheqje nga posti politik. Po këtë vit caktohet sekretar në Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Shëndetësi. Gjatë viteve 1986-1990 ushtroi detyrën e nënkryetarit të Kuvendit Komunal të Preshevës. Aktivitetin politik nuk e ndërpreu as në periudhën e pluralizmit pas vitit 1990. (Ilir Zylfiu).

KREDIA BANKARE. Një borxh i dhënë nga një entitet (organizatë ose individ) për një entitet tjetër, me një normë të caktuar interesi dhe që dëshmohet nga një notë që specifikon, ndër të tjera, shumën e principalit, normën e interesit dhe datën e shlyerjes. Kredia zakonisht lëshohet me një kosto, e cila paraqet shumën shtesë, mbi shumën e marrë hua, që huamarrësi duhet të paguajë. Kjo kosto përfshin interesin, shpenzimet administrative dhe të gjitha shpenzimet e tjera. Disa shpenzime janë të detyrueshme, të kërkuara nga huadhënësi, si pjesë përbërëse e marrëveshjes së kredisë, disa të tjera mund të jenë opcionale. Në një kredi ligjore detyrimet dhe kufizimet janë të sanksionuara me kontratë, e cila mund të përmbajë edhe kushte shtesë për huamarrësin. Kreditë lëshohen kryesisht nga bankat, por mund të lëshohen edhe nga institucione të tjera financiare jobankare. Në vitin 2014 dinamika e aktivitetit kreditues në Kosovë vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tri vitet e fundit. Gjithsej kreditë arritën vlerën 1,9 miliardë euro në dhjetor 2014, një rritje vjetore prej 4.2%. Struktura e kredive në Kosovë dominohet kryesisht nga kreditë për ndërmarrjet, që kanë një pjesëmarrje prej rreth 66% në tërësinë e portfolios kreditore, pasuar nga kreditë për ekonominë familjare, me pjesëmarrje prej rreth 34%. Struktura e kredive të ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike, dominohet nga kreditë e destinuara për tregti, me pjesëmarrje prej 53%, pasuar nga sektori i prodhimtarisë me 12% dhe sektori i ndërtimtarisë me 8%. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë qasje më të ulët në financimin bankar, me pjesëmarrje prej 4.0% në kreditë për ndërmarrjet. Sipas afatit të maturimit, struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat maturimi mbi 1 vit dhe deri në 5 vjet. (Arben Mustafa)

KRENA. Lumë në pjesën perëndimore të Dukagjinit, me gjatësi 23 km. Buron te krojet e Hasan Agës, te Bjeshkët e Vokshit, rrjedh në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, duke kaluar nëpër qytetin e Gjakovës. Në pjesën e rrafshët të lumit Krena janë të përhapura tokat aluviale, kurse në lugina ka toka argjilore, deluviale, humusore, ndërsa zënë sipërfaqe të konsiderueshme edhe tokat skeletore, të përbëra nga rëra dhe zhavorri. Krena e ndan qytetin e Gjakovës në dy pjesë: pjesa e djathtë në lindje të pllajës së Çabratit, me Çarshinë

e Madhe dhe me rrugën që shpie në Qafë të Prushit dhe në Qafë të Morinës, pjesa e majtë, në të cilën gjendet qendra e qytetit dhe magjistralia Prizren-Gjakovë-Pejë. Në qytet prej Shpatit të Sylpejës në veri e deri në derdhje në lumin Erenik, te spitali i qytetit, Krena kalon nëpër 11 ura. Me ujin e Krenës janë furnizuar mullinjtë e Gjakovës. Prej Urës së Rexhep Agës deri tek Ura e Taliqit, shtrati i Krenës është rregulluar, pjesa tjetër në veri dhe në jug gjatë prurjeve në prill-maj dhe në nëntor rrezikon me gërryerje dhe shembje të pjesët e banuara pranë brigjeve të lumit. Lumi është i rrezikuar nga ndotjet urbane. Ai tashmë ka humbur vetitë fizike dhe kimike, duke ngelur edhe pa faunë. (Nesim Vala)

KRËSTIQ Miliq (Milić Krstić) (1887-1938).

Paramilitar dhe vojvodë çetnik serb ndërmjet dy luftërave botërore. Lindi në Istog. Njihet mirë gjuhën shqipe, vishej me tirq, me shokë, shall e plis të bardhë, për të mos u hetuar se ishte kriminel serb. Ishte pjesëtar i organizatave terroriste "Dora e Zezë" dhe "Dora e Bardhë", të cilat vepronin me formacione paramilitare çetnike. Ishte në krye të 200-300 kriminelëve të armatosur serbë e malazezë, por edhe shqiptarë, duke kryer vrasje, plaçkitje dhe djegie në fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit, të Drenicës dhe të Sanxhakut. Krime bëri sidomos në Jabllanicë të Gjakovës, në Beleg, në Cermjan, në Rashkoc, por edhe në Istog dhe në mbarë Podgurin. U vra në pranverën e vitit 1938 nga Selman Kadria (1906-1938) i Istogut, të cilin më pas e vranë xhandarët serbë. Vrasja e tij pati jehonë të madhe në Rrafshin e Dukagjinit dhe më gjerë. (Muhamet Shatri)

KRINDELLI. Fortifikatë dardane-bizantine (shek. IV-VI) në një lartësi prej 720 m, që shtrihet rreth 10 km në lindje të komunës së Kamenicës. Fortifikata shtrihej në anën e majtë të rrjedhës së lumit të Desivojcës, ndërsa nga ana e djathtë rrethohej nga lugina e lumthit dhe fushëgropa e fshatit Krindell. Ndonëse nuk janë bërë asnjëherë hulumtime arkeologjike, duket se kemi të bëjmë me një fortifikatë që daton nga periudha e hershme bizantine. Pozita e saj, pos me fshatin ku ndodhej, më tepër komunikon me luginën, e cila nga fshati Desivojcë bashkonte disa fshatra deri te lumi Moravë. Në bazë të gjurmëve nga terreni, rruga (kalldrëmi)

krijonte një vijë gjarpërore deri në lartësinë e fillimit të mureve të fortifikatës, përkatësisht deri te hyrja në pjesën veriperëndimore. Vendi i ndërtimit është një rrafshnaltë e përbërë nga dy tarraca, prej të cilave ajo e përgut kishte sipërfaqe më të madhe dhe, brenda mureve rrethuese, ruhen themele të shumta dhe disa kthina, sidomos nga ana juglindore. Hyrja në kala shoqërohej me një kullë vrojtuese nga ana veriperëndimore, ndërsa pjesët relativisht të ruajtura të mureve ndodhen në pjesën veriore. Me matje të rëndomta është vërejtur se fortifikata ka formën e majës së heshtës, muret kanë trashësi nga 1.80-2 m, ndërsa në vijën veriperëndim-juglindje fortifikata ka gjatësi dhe gjerësi rreth 260 x 90 m. Aktualisht gjendja e kësaj fortifikate është e keqe. Pjesa më e madhe e mureve janë shembur, lokacioni i monumentit është nën rrënoja, ndërsa dendësia e madhe e drunjve gjithashtu shkakton dëmtime të vazhdueshme. (Faik Sahiti)

KRISOBULA E BANJSKËS (1313-1318).

Kartë dhurimi për ngritjen e kishës së Shën Stefanit në katundin Banjskë të Mitrovicës. Njihet edhe si Krisobula e Shën Stefanit. Është një kartë dhurimi që mbreti Stefan Urosh II Milutin (1282-1321) e nënshkroi, mbase midis viteve 1313-1318, pasi kishte përfunduar së ndërtuari kishën kushtuar Shën Stefanit në Banjskë, në të cilën do të varrosej mbreti serb. Karta ishte shkruar në formë rotulusi, por së shpejti, me qëllim të përdorimit më praktik u rishkrua në pergamenë, në formë libri. Me këtë kartë sundimtari i falte manastirit katune, katunde, njerëz e prona në brigje të Ibrit, Sitnicës e Llapit, në krahinën Hvosno, përkatësisht në hapësirën midis Pejës dhe Istogut (Kosovë) dhe në Ras (Serbi), në Plavë, Budimlje e në Zetë (Mal të Zi). Përmes kësaj karte përcaktoheshin hollësisht detyrimet dhe privilegjet e bujqve, blegtorëve, të zejtarëve dhe të vartësve të tjerë, që do t'i kishin kundrejt atij manastiri. Originalin në pergamenë të kësaj krisobule e morën me vete osmanët, pas dëmtimit që i bënë këtij manastiri pas Betejës së Kosovës (1389) dhe që atëherë ruhet në arkivin e sulltanit në Sarajet e Moçme në Stamboll. Një kopje e kësaj krisobule, në formë libri, u gjet në vitin 1889 në arkivin e Stambollit dhe u përshkrua e u botua në vitin 1890 në Beograd dhe në Vjenë. (Skënder Gashi)

KRISOBULA E GRAÇANICËS (1321). Kartë dhurimi për ngritjen e Manastirit të Graçanicës, e shkruar dhe e dekretuar në vitin 1321 nga sundimtari rasian, Stefan Uroshi II Milutin (1282-1321), i derës së Nemanjidëve, me rastin e themelimit të Manastirit të Graçanicës. Në këtë dokument numërohen të gjitha pronat tokësore, të përcaktuara saktësisht, në rrethina të sotme të Prishtinës dhe katundeve përreth saj dhe të komunës së sotme të Lipjanit, që sundimtari i Rashës i falte këtij manastiri. Në këtë dokument jepen edhe emrat e katundarëve bujkrobër të këtij manastiri, që duhej të rrogonin për këtë manastir, shumica e të cilëve ishin vllahë, por në kuadrin e institucionit të pleqnarëve kishte edhe individë që kishin ruajtur ndonjë antroponim të gjithëkrishterë në variantin shqip të tij. Dokumenti mbahet si burim i rëndësishëm për historiografinë serbe, sepse këtu, në një kapitull të veçantë, është dhënë edhe regullativa ligjore/juridike “Ligji i vjetër i serbëve”. (Skënder Gashi)

KRISOBULA E MANASTIRIT TË SHENJTORËVE MËHILL E GABRIEL TË PRIZRENIT (1348?). Krisobulë e nënshkruar me gjasë në vitin 1348, nga sundimtari i Rashës, Stefan Dushani, me rastin e themelimit të manastirit në Prizren. Në kuadrin e zotërimeve të këtij manastiri ishin 7 kisha me gjithë pronat (toka buke, vreshta dhe bletarë), bashkë me njerëzit e tyre, që do të rrogonin për të, pastaj një minierë hekuri në rajonin e Toplicës, 467 familje të vllahve, 8 katune të “arbanasëve” dhe disa zejtarë (midis tyre edhe argjendarë) të qytetit të Prizrenit, ndër të cilët ishte edhe një vorbëtar me antroponimin karakteristik shqiptar Lesh. Manastiri e kishte edhe një spital, i cili ishte i detyruar t’i mjekonte të gjithë të sëmurët. Në krisobulë thuhet se manastiri duhej të furnizohej pa pagesë, me kripë, mëndafsh, verë, mjaltë, peshk (nga liqenet e Shkodrës dhe të Plavës) dhe me vaj ulliri nga Tivari. Furnizues të obligueshëm (në mënyrë të veçantë për vajin e ullirit nga Tivari) ishin caktuar shprehimisht “arbanasët”. Manastiri do t’i vilte edhe të ardhurat financiare nga tregu dhe nga dogana e qytetit të Prizrenit. Ky dokument përmban shumë mikrotoponime (midis tyre edhe me prejardhje shqipe e romane-ballkanike) të katundeve përreth Prizrenit, të rajonit të Gorës, Suharekës, Rahovecit, Malishevës dhe të Rrafshit të Kosovës dhe ofron të

dhëna për shtrirjen e katuneve të “arbanasëve” dhe të katuneve vllahë të këtyre hapësirave. (Skënder Gashi)

KRISOBULA E ZHIÇËS (1222-1228). Janë dy krisobula të mbretit Stefan i Kurorëzuar i Parë dhe të të birit Radosllav, me rastin e themelimit të manastirit në rrethina të Krlevës (Serbi), që mbahet edhe si akt zyrtar i themelimit të Peshkopatës së mëvetshme të Kishës Ortodokse të Rashës (1219). Pjesa më e madhe e tekstit të Krisobulës së Zhiçës përmban të dhëna për pronat që i faleshin këtij manastiri/peshkopate. Sundimtari rasian ia falte këtij manastiri 57 katunde e lagje të tyre, që kapnin një sipërfaqe prej më shumë se një mijë hektarësh dhe disa mijëra njerëz që i punonin ato toka ose merreshin me zeje të ndryshme. Pjesa më e madhe e atyre pronave ishin në rrethina të vendit ku po ngrihej kisha e pavarur serbe, por asaj iu dhanë edhe prona në krahinën Hvosno të Kosovës dhe në Mal të Zi. Nga territori i sotëm i Kosovës, këtij manastiri/peshkopate i faleshin Peja (atëherë katund) me lagjet e saj, katundet e sotme Carravër, Shtupeq, Treboviq, Gorazhdë, Nakëll, Çellopek, Llabjan dhe Lutogllavë. Sundimtarë të tjerë do t’i falin më vonë kësaj ipeshkvie edhe pasuri të tjera edhe në Rrafshin e Kosovës dhe në krahinën e Drenicës. Manastiri u dogj në fund të shek. XIII dhe, për pasojë, qendra e peshkopatës u bart në Pejë. (Skënder Gashi)

KRISOBULAT E DEÇANIT (1330). Kartë dhurimi për ngritjen e Manastirit të Deçanit (1330, 1335). Kjo krisobulë është shkruar në vitin 1330 në papirus në oborin e mbretit, i cili ishte në Nerodime (rrethina e Ferizajt) dhe është nënshkruar dhe vulosur me vulë të artë nga mbreti i Rashës Stefan Uroshi III, i cili më vonë do të njihet me ofiqin “i Deçanit” dhe që ishte i biri i mbretit Milutin dhe i ati i perandorit Stefan Uroshi IV Dushani. Janë ruajtur tri versione të kësaj krisobule, të cilat dallojnë për nga gjuha dhe ortografia. Ndërtimi i manastirit nisi në vitin 1327 dhe përfundoi në vitin 1335. Përmes kësaj krisobule sundimtari i falte manastirit bjeshkë, kullota dhe toka buke, përkatësisht 151 katunde dhe 18 bjeshkë, me rreth 20,000 hektarë, bashkë me rreth 15,550 njerëz që përbënin gjithsej 2,432 familje, të cilët gjithashtu do të bëheshin pronë e manastirit. Këto prona, bashkë me njerëzit e falur,



KRISOBULA E PARË E MANASTIRIT TË DEÇANIT (1330)

shtriheshin në hapësirën nga Drini i Bardhë deri në Kom të Malit të Zi dhe nga Deçani deri në luginën e Valbonës në Shqipëri. Pronat që i faleshin këtij manastiri nuk kishin qenë deri atëherë prona të tij. Disa nga ato prona mbreti i blinte me dele, desh e me qengja, por pjesa më e madhe e tyre ishin toka të feudalëve lokalë dhe të vëllazërive/katuneve blegtorale të “arbanasëve” që po shpronësoheshin. Këtyre të fundit u ndalohej madje edhe të përmendnin se akëcila tokë apo bjeshkë/kullotë ka qenë dikur pronë e tyre. (Skënder Gashi)

KRISTAJ Frrok (1944-). Gazetar. Lindi në Zym të Hasit. Shkollimin fillor e filloi në Zym dhe e kreu në Rakosh të Istogut, shkollën normale e kreu në Prizren, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Gjiilan. Vijoi studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin Filologjik dhe për gjeografi në Fakultetin e Shkencave të Universitetit të Prishtinës. Punoi mësimdhënës në Planejë, Mazrrek, Gjonaj e Zym të Hasit dhe në Akademinë Pedagogjike në Prizren. Nga viti 1978 punoi gazetar në të përditshmen “Rilindja” dhe pastaj në “Bota sot” dhe “Iliria post”. Botoi shkrime të ndryshme publicistike në shumë gazeta dhe revistat në gjuhën shqipe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Shqipëri etj. Është autor i disa veprave poetike dhe i monografive për Katarina Josipin, imzot Nikë Prelën, Anton Pashkun dhe gazetën “Rilindja”. Ka dhënë kontribut për organizimin dhe

mbajtjen e disa aktiviteteve dhe manifestimeve letrare e kulturore, si “Takimet e Gjeçovit” në Zym të Hasit etj. Është botues i revistave “Zëri i Hasit” dhe “Kosovari”. (Shefqet Rexhepi)

KRISTALET. Janë trupa të ngurtë homogjenë, të formuar nga proceset fiziko-kimike të zhvilluara në natyrë, ose të krijuar në mënyrë artificiale në laborator, që janë të kufizuar nga jashtë me faqe të rrafshëta dhe me forma të rregullta gjeometrike. Te kristalet, grimcat elementare (atomet, jonet, molekulat) janë të vendosura me rregullsi në një të rrjetave hapësinore e kristalografike. Në Kosovë mineralet e vendburimit të plumb-zinkut të Trepçës në Stantërg, në masë më të madhe, paraqiten me kristalizim të përsosur në formë të kristaleve jashtëzakonisht të bukura, kristale dhe minerale që koleksionohen, ruhen dhe janë të ekspozuara në Muzeun e Kristaleve dhe të Mineraleve të Kosovës në Stantërg (Mitrovicë), i themeluar në vitin 2012, të cilit i ka paraprirë krijimi i kahershëm i Muzeut të Kristaleve të Trepçës (1963). Në muze janë të ekspozuara mbi 1,150 ekzemplarë të më shumë se 51 llojeve të ndryshme të kristaleve, si: vivijanit, kuarc, kalcit, pirit, pirotinë, sfalerit, galenit, plumozit dhe shumë të tjerë. (Hashim Këpuska)

KRISTOFORIDHI Konstandin (Nelko) (1827-1895). Prozator, përkthyes, filolog. Kreu arsimin fillor në qytetin e lindjes në Elbasan, më pas gjimnazin Zosimea në Janinë.



KONSTANDIN KRISTOFORIDHI

Aty u njoh dhe bashkëpunoi me albanologun e shquar austriak Johan Georg Fon Han, për veprën e tij “Studime shqiptare”. Në vitin 1851 shkoi për studime në Maltë, ku studioi në një seminar protestantësh. U kthye në Shqipëri dhe punoi si mësues në një shkollë greke në Tiranë. Shërbeu si përkthyes mes ushtarëve shqiptarë që luftonin në radhët e trupave angleze gjatë Luftës së Krimesë. Prej aty shkoi në Londër për studime (mendohet të ketë studiuar rreth tre vjet) e këtu ra në kontakt me shoqërinë biblike. Pikërisht ky takim përcaktoi edhe rrjedhën e jetës së tij: u bë përkthyes i teksteve biblike, por para se t’ia nisë punën për përkthimin e teksteve biblike në shqip, udhëtoi për qëllimet e kësaj

shoqërie në Tunis, Stamboll, më pas u kthye në Elbasan. Me t'u kthyer në Elbasan filloi një udhëtim nëpër Shqipëri, për të njohur shqipen; qëndroi në Berat dhe në Shkodër, udhëtime që e kanë ndihmuar për njohjen e dialekteve të shqipes, e cila do t'i shërbente qoftë për përkthimet e teksteve të shenjta, qoftë për mbledhjen e leksikut me qëllim të hartimit të fjalorit dhe gramatikës, qoftë për prozën "Gjahu i Malësorëve", që është më tepër një demonstrim gjuhësor bidialektal sesa një demonstrim i talentit të tij prej shkrimtari. Si autor letërsie Kristoforidhi mbetet në kulturën shqipe pikërisht me prozën e shkurtër "Gjahu i malësorëve" (1884), e shkruar në dy dialekte, gegërisht dhe toskërisht. Më tej, varianti gegërisht është shkruar në dy nëndialekte, në gegërishten e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Tregimi nuk ka subjekt, është i ndërtuar mbi dialogun dhe ka formën e një afresku të gjallë dhe me koloirit që përshkruan ambientet e jetës shqiptare. Tekstet biblike të përkthyer prej tij "Katër ungjillat dhe punët e apostujve" (gegërisht 1866), "Dhiata e re", (gegërisht 1869, toskërisht 1870), "Katër katekizmat" (gegërisht 1872), "Psaltiri" (gegërisht 1868, toskërisht 1872), "Të bërët dhe të dalët" (toskërisht 1880), "Historia e së shenjtësë shkronjë" (gegërisht 1870, toskërisht 1872) janë një kontribut i madh jo vetëm në nivel religjioz, por edhe për shkrimin e shqipes dhe shndërrimin e saj në gjuhë të përpunuar kulture. Përpjekja për ta sistemuar dhe ngritur shqipen në rangun e një gjuhe kulture mes bashkëkombësve të tij shfaqet edhe në veprat e tij gjuhësore: "Abetar shqip" (gegërisht 1872), "Alfavitari shqip" (toskërisht 1867), "Gramatika e gjuhës shqipe" (toskërisht 1882), "Fjalori shqip-greqisht" (1904). Pas vdekjes iu botuan në revistën "Kopshti letrar" edhe veprat "Jetëshkronja e njerëzve të ndriçim" (1918) dhe "Sistemi diellorë" (1918). (Mark Marku)

KRISTOFSON Jyrgen (Jürgen Kristophson) (1935-) Gjuhëtar gjerman, profesor. Studiuës me interesime për latinizmat dhe romanizmat, por edhe për sllavishten dhe gjuhët e Ballkanit. Profesor në Universitetin e Bohumit në Gjermani. Ka shkruar studime për rumanishten dhe gjuhët e Ballkanit, për gjuhën shqipe dhe raportet e saj me gjuhët e Ballkanit, për fjalorin e Dhanilit, për emrat e ditëve të javës dhe emrat kalendarikë. I rëndësishëm në albanistikë është studimi i tij për romanizmat e

shqipes "Elementet romane në gjuhën shqipe" (Romanische Elemente im Albanischen, 1988), që shpërfaq shtresëzimin kompleks kohor, hapësinor dhe të varieteteve të ndryshme romane në shqipen. Rëndësi kanë vrojtimet e tij për raportet e këtyre elementeve të shqipes me rumanishten. (Hana Radoniqi)

KRISHTERIMI I HERSHËM NË DARDANI.

Për përhapjen e krishterimit në Dardani flasin burimet materiale dhe të shkruara. E dhëna e parë që flet për fillimin e krishterimit është mbi martirizimin e dy vëllezërve gurgdhendës, ndoshta edhe binjakë, Florit dhe Laurit, të cilët u persekutuan në Ulpianë, sepse faltoren pagane që e ndërtuan vetë ia kushtuan Krishtit. Këta janë dhe martirët e parë të njohur të Dardanisë, të cilët duhet të jenë ndëshkuar gjatë gjysmës së parë të shek. II, menjëherë pas ndëshkimit të mësuesve gurskalitës të tyre të krishterë në kohën e Hadrianit (117-138), Prokulit dhe Maksimit. Së bashku me Florin e Laurin, në ndërtimin e këtij tempulli përmenden edhe shumë të tjerë, të cilët kishin filluar ta përfaqonin krishterimin, për çarsye edhe u ndëshkuan. Këto të dhëna flasin se fillimi i krishterimit në Dardani duhet kërkuar në gjysmën e parë të shek. II. Burimi i parë i shkruar që flet për organizimin institucional të krishterimit dardan është Koncili i Parë i Përgjithshëm i mbajtur në Nike të Azisë së Vogël (325), ku mori pjesë ipeshkvi, përkatësisht mitropoli i Dardanisë, Daku, i cili në dokumente nënshkruhet si Dacus Dardaniae, që është titullari i saj i parë. Vetë pjesëmarrja e tij si mitropolit i krejt trevës flet se hierarkia e Kishës Dardane u themelua para Koncilit, prandaj edhe përvetësimin dhe përhapjen e krishterimit duhet kërkuar më herët. Selia e parë ipeshkvnore gjendej në Scupi, e cila u themelua menjëherë pas Ediktit të Milanos (313), e që së shpejti u bë edhe mitropoli, titullari i parë i së cilës ishte Daku. Në shek. IV u themeluan edhe tri seli të tjera ipeshkvnore: Ulpiana, Naissus dhe Remesiana, të cilat i takonin mitropolisë së Scupit. Pas tërmetit të vitit 518, në kohën e Justinianit, me organizimin e ri të kishës ilirike, qendër e re u bë Justiniana e Parë, e cila u bë qendër civile dhe fetare, argjipeshkvi e Ilirikut. Për ecurinë e Kishës Dardane, pos të dhënave me rëndësi që ofrojnë dokumentet për koncilet, ku shqyrtoheshin ngjarje me rëndësi kishtarë dhe

figurojnë emrat e ipeshkvijve dhe të qendrave ipeshkvnore, të dhëna ofrojnë dhe letrat shkëmbyese ndërmjet papëve dhe personave kishtarë të kësaj treve, në të cilat kryesisht bëhet fjalë për lidhjet e kësaj kishe dhe në përgjithësi të Ilirikut me Selinë e Shenjtë. Nga këto kuptohet edhe rregullimi i brendshëm i kishës, në hierarkinë e së cilës ishin të pranishëm abatët, arkimendritët dhe xhakonët, gjë që tregon se ka qenë e organizuar mirë jeta e kishës.

Burimet materiale ofrojnë po ashtu të dhëna të vlefshme, përmes motiveve dhe simboleve, pjesën më të madhe të të cilave e zënë monumentet funerare: sarkofagë, pllaka dhe varreza të muruara me afreska. Sarkofagët janë të pranishëm me dy ekzemplarë nga plumbi të qendrave të ndryshme urbane. Njëri është nga Municipiumi DD dhe për nga ikonografia paraqet një ekzemplar të veçantë. Dekorimi i tij ka figura shtazësh dhe objektësh, përfshirë dhe peshkun dhe qengjin, dy simbolet më të hershme të besimit të krishterë. Sarkofagu i takonte një të krishteri, i cili përkatësinë në religjionin e ri e shpreh me këto simbole dhe, si i tillë, deri tash paraqet monumentin më të hershëm me ikonografi krishtere. Sarkofagu tjetër është nga Naisi dhe më i vonë, përkatësisht i takon gjysmës së dytë të shek. IV. Është i dekoruar me kryq të skalitur në kapak, me simbolin kryesor të krishterimit dhe me paraqitje figurative të Trinisë së Shenjtë dhe dy apostujve të veshur me fustane. Edhe pllakat janë të pranishme në numër të kufizuar dhe që të gjitha, 7 sosh, janë gjetur në Nais, ku ekzemplarët më të hershëm i takojnë shek. IV, ndërsa më të vonshmet shek. V-VI. Varrezat e muruara me afreska (5 sosh) janë objekte monumentale dhe të gjitha janë nga nekropoli i Naisit. Këto janë mbuluar me qemer gjysmëharkor dhe afreskat përmbajnë simbole, figura dhe skena të kultit të krishterë. Varreza më e rëndësishme i takon fundit të shek. IV, te e cila në murin e anës lindore, atë të hyrjes, janë paraqitur figurat e dy apostujve në këmbë, Shën Pjetrit dhe Shën Palit, në mes të të cilëve gjendet monogrami i Krishtit brenda kurorës së palmës, duke treguar analogji me katakombet e Romës. Pjesën tjetër e përbëjnë monumentet e jetës së përditshme, ku një vend të veçantë e zënë llambat (lucernat). Dy më të hershme janë të punuar në argjilë dhe vijnë nga Naisi: në diskun e njëres janë paraqitur dy peshq (gjysma e dytë e shek. III - gjysma e parë

e shek. IV), kurse në diskun e tjetrës, që është import afrikanoverior, gjendet monogrami i Krishtit (fundi i shek. IV - fillimi i shek. V). Dy llambat e tjera (shandane) janë punuar në bronz dhe janë gjetur në pjesën qendrore dardane, në Tërnoc të Bujanocit (shek. V-VI). Që të dyja kanë kryq oriental, përkatësisht grek dhe njëra ka formë peshku. Mbetjet arkitekturore të kultit të krishterë, bazilikave, dy nga Naisi të kohës së Konstantinit dhe një nga Banjica e Pejës me kriptë, martirium (mesi i shek. IV - gjysma e parë e shek. V), deri tash përbëjnë kishat më të hershme, për t'u bërë në numër më të madh në shek. V dhe sidomos në shek. VI. Themelet e tyre janë zbuluar në mbarë territorin dardan: në Kosovë, pos Ulpianës, në shumë vende, si në Vërmicë, Bellacërkë, Gradishtë të Korishës, Gradishën e Harilaqit, në Kasterc etj; në pjesën jugore në Scup dhe territorin e tij mbi dhjetë, si edhe në Konjuh të Kumanovës; në pjesën veriore të nekropolit të Naisit (5 sosh), Klisurë, Remesianë, Kurshumli, Cariçin Grad te Leskovci. Është konstatuar se shumë kisha mesjetare janë ndërtuar mbi themelet e kishave të hershme krishtere: e Zonjës së Bekuar në Studenicë afër Pejës, e Shën Prendës në Prizren, kisha e vogël në Lipjan kushtuar Shën Florit dhe Shën Laurit, kisha e Shën Pjetrit e Palit në Rras, kisha e dikurshme në grykën e Kaçanikut, kisha e vjetër në Prokuple, kisha në Curlin afër Nishit dhe ato në luginën e Timokut etj. (Exhlale Dobruna-Salihu)

KRITIKA LETRARE. Letërsinë shqipe në Kosovë, që nga botimet e para e deri më sot, e ka përcjellë kritika letrare si formë e komunikimit intelektual me veprat letrare. Në filltet e saj në Kosovë, duke njohur edhe trashëgiminë e kritikës letrare shqiptare, gjykimi letrar nis me emrat e Vehap Shitës e Hasan Mekulit. Forma e recensionit dominon fazën nistore, qoftë si kritikë impresioniste e afirmative për vepra të caktuara, qoftë si kronikë e produksionit letrar shqiptar. Mirëpo kahet e reja krijimtare dhe shtimi i shkrimit të formave të ndryshme letrare nga autorët tanë kanë ndikuar në hapjen e kritikës letrare drejt hulumtimeve të reja. Përveç kësaj, kritika forcon aparaturnë shkencore dhe përveç veprës së autorëve të Kosovës analizon e studion letërsinë shqipe në përgjithësi. Prijatarë të konsolidimit të kritikës letrare në Kosovë dhe të shndërrimit të saj në bibliotekë në vete janë Ali Aliu, Rexhep

Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Mensur Raifi etj. Duke ikur nga kritika dogmatike, forcohen teoritë e metodat moderne të studimit letrar. Ali Aliu në vepra të shumta të nisura si “Kërkime” (1971) e të vijuar me stil të njëjtë kultivon kritikën integrale të veprave në formën e recensionit. Rexhep Qosja shquhet për kritikën sociologjike-integrale të autorëve shqiptarë e sidomos me studimet për periudhën e romantizmit të “Historia e letërsisë shqipe I, II, III” (1984-86). Ibrahim Rugova me kritikën gjenetike e semiotike të “Vepra e Bogdanit 1675-1685” (1982), por edhe me historinë e kritikës të “Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare 1504-1983” (1986). E veçanta e këtij autori të kritikës është analiza e veprave të autorëve bashkëkohorë të Kosovës, shkrime të cilat më vonë botohen të “Refuzimi estetik” (1986). Sabri Hamiti, studiues sistematik i letërsisë shqipe, realizon vepra studimore fenomenologjike-hermeneutike si dhe kurorëzon poetikën historike të letërsisë shqipe me serinë e veprave që nga “Variante” (1974) deri tek “Albanizma” (2009). Rexhep Ismajli studioi tekstet e vjetra shqipe në aspektin e historisë së gjuhës të studimit “Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbërit” (1706)” (1985), “Pjetër Budi - Poezi 1618-22” (1986) dhe “Poezi e sotme arbëreshe” (1990), por u shqua edhe me përkthimin e studimeve gjuhësore të Martinesë, Sosyrit, Bartit etj. Mensur Raifi në kritikën letrare të Kosovës solli vrojtimin psikanalitik, sidomos kur studioi autorët e traditës të studimi “Fan S. Noli dhe Migjeni” (1979). Emër i shquar i kritikës letrare është edhe Bajram Krasniqi, i cili me metodën historiciste analizoi prozën shqipe të studimi “Poetika e romanit historik shqiptar” (1985), pastaj Sylejman Sylja, Hysni Hoxha, Ali D. Jasiqi etj. të cilët kultivuan formën e recensionit. Plejadës së traditës së krijuar nga këta autorë të kritikës letrare, sidomos trashëgimisë fenomenologjike-hermeneutike e semiotike të Rugovës, Hamitit, Ismajlit etj, i shtohen edhe emrat e tjerë siç janë Kujtim Rrahmani, Femi Cakolli, Kujtim M. Shala, Nysret Krasniqi, të cilët me shumësinë e qasjeve vrojtuese autentike dhe me respektimin e traditës së mendimit letrar shqiptar e botëror janë në proces të kontinuitetit të sprovave dhe provave të analizës së vlefshme të letërsisë shqipe. (Nysret Krasniqi)

KRIVAREKA. Lumë në pjesën lindore të Kosovës, dega kryesore e Moravës së Binçës. Buron nga fshati Marec, komuna e Novobërdës. Nga fshati Krilevë njihet me emrin Krivareka. Sipërfaqja ujëmbledhëse është 612.5 km², gjatësia 49 km. Pellgu shtrihet në skajin lindor të Kosovës, që karakterizohet me reshjet më të vogla, gjë që është reflektuar në prurjet e lumit. Prurja mesatare vjetore është 4.2 m³/s. Dallohet me prurje shumë të luhatshme të ujit gjatë vitit. Maksimumin e prurjeve e ka gjatë muajit maj (6 m³/s), ndërsa minimumin e prurjeve gjatë muajit gusht (0.7m³/s). Në afërsi të fshatit Korminjan bashkohet me Moravën e Binçës. (Arsim Ejupi)

KRIZA FINANCIARE. Situata në të cilën vlera e aseteve të institucioneve financiare zvogëlohet me shpejtësi. Kriza financiare është e lidhur shpesh me një panik apo një tërheqje të madhe të depozitave nga bankat, ku investitorët shesin pasuritë ose tërheqin para nga llogaritë e kursimeve, për shkak të pritjeve se vlera e këtyre aseteve do të bjerë, nëse ato mbeten në një institucion financiar. Situata të tjera të krizës financiare mund të përfshijnë dështimin e tregut të aksioneve, zhvlerësimet e mëdha të valutave, dështimin e shteteve për të paguar borxhet etj. Krizat financiare më të mëdha ekonomike në nivel global janë kriza e viteve 1929-1933 dhe kriza e vitit 2008, të cilat i patën përfshirë kryesisht vendet e zhvilluara dhe sollën pasoja të rënda ekonomike. Ekonomia e Kosovës nuk pati pasoja të mëdha nga kriza e fundit globale, kryesisht për shkak të ekspozimit jo të madh të ekonomisë ndaj sektorit të jashtëm, si dhe për shkak të pozicionit të qëndrueshëm fiskal dhe sistemit të shëndoshë financiar. (Sokol Havolli)

KRIZA LINDORE (1875-1878). Krizë e nxitur si pasojë e rënies së mëtejshme të Perandorisë Osmane dhe luftës së popujve të Ballkanit për çlirim kombëtar nga zgjedha osmane. Faktorët kryesorë që e shkaktuan Krizën Lindore të viteve 1875-1878 janë: dobësimi i Perandorisë Osmane; përpjekjet e Fuqive të Mëdha për të dominuar në Mesdhe dhe në Gadishullin Ballkanik; forcimi i lëvizjes çlirimtare të popujve të Ballkanit; nxitja e pansllavizmit nga Rusia etj. Për shkak të pakënaqësisë së popullsisë sllave të krishterë me sundimin osman, në korrik të vitit 1875

filloi kryengritja në Hercegovinë, e cila në muajin tjetër u zgjerua edhe në Bosnjë. Në prill të vitit 1876 shpërtheu kryengritja edhe në Bullgari. Kundërpërgjigja e ushtrisë osmane që e ashpër dhe arriti të shuante këto kryengritje. Në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut të vitit 1876, Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Ato i ndihmoi edhe Rusia me 30,000 vullnetarë. Një javë pas shpërthimit të kësaj lufte, më 8 korrik 1876, Rusia dhe Austro-Hungaria firmosën një marrëveshje të fshehtë në Rajhshtat, e cila, ndër të tjera, sipas notës austro-hungareze, parashihte formimin e një shteti autonom shqiptar, që do të përfshinte edhe një pjesë të territorit të Kosovës. Me gjithë ndihmën e Ruisë, ushtritë e Serbisë dhe Malit të Zi pësuan disfatë përballë forcave ushtarake osmane. Nën ndikimin e Ruisë, aksione luftarake kundërosmane në fund të vitit 1876 dhe në fillim të vitit 1877 ndërmori edhe kapedani i Mirditës, Preng Bibë Doda. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, më 24 dhjetor 1876 në Stamboll nisi punimet Konferenca Ndërkombëtare e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha. Po atë ditë sulltan Abdyl Hamiti II shpalli Kushtetutën e Mithat Pashës, sipas të cilës zgjidheshin të gjitha problemet e kombësive nën Perandorinë Osmane. Rrjedhimisht, Rusia nuk shprehu besim ndaj Konferencës Ndërkombëtare, prandaj filloi përgatitjet për luftë. Paraprakisht, më 15 janar 1877 Rusia dhe Austro-Hungaria nënshkruan një marrëveshje të fshehtë në Budapest, sipas të cilës Austro-Hungaria do të qëndronte asnjëherë në luftën e ardhshme ruso-osmane, fitonte territore në Bosnjë e Hercegovinë dhe të dy fuqitë njihnin një shtet autonom shqiptar. Fuqitë e Mëdha në Konferencën Ndërkombëtare të Londrës, në mars të vitit 1877 nënshkruan një protokoll, i cili parashihte që viset e Kaçanikut, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës e të Dibrës deri në Drin t'i aneksoheshin Bullgarisë. Mirëpo, Rusia doli e pakënaqur nga punimet e kësaj Konference dhe më 24 prill 1877 i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Kësaj lufte, përkrah Ruisë, iu bashkua edhe Mali i Zi dhe Serbia. Në terren forcat ushtarake ruse shënuan fitore të rëndësishme. Ato në dhjetor të vitit 1877 thyen edhe qëndresën e Plevnës, kurse më 4 janar 1878 pushtuan Sofjen, më 18 janar Edrenenë dhe më 28 janar arritën në fshatin Shën Stefan, në periferi të Stambollit. Njëkohësisht edhe ushtritë serbe e malazeze pushtuan vise të

vilajetit të Kosovës e të Shkodrës. Disfata e ushtrisë e detyroi Stambollin zyrtar të kërkonte paqe me Ruisë. Ajo u nënshkrua më 3 mars 1878 në Shën Stefan. Sipas Traktatit të Shën Stefanit, viset shqiptare të vilajetit të Kosovës copëtoheshin në favor të Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Ky Traktat u kundërshtua nga Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria, prandaj vendimet e tij u vendos të rishikohen në një Kongres Ndërkombëtar, që u mor vendim t'i zhvillonte punimet në Berlin. (Fitim Rifati)

KROATISHTJA. Gjuhë e veçantë në grupin e gjuhëve sllave jugore, gjuhë kombëtare e kroatëve. Kroatishtja (me dialektet kajkavishte, čakavishte dhe shtokavishte ijekavishte dhe ika-vishte) dallon lehtë nga serbishtja (shtokavishte kryesisht ekavishte e vetëm pjesërisht ijekavishte), malazesishtja (shtokavishte ijekavishte) dhe bosnjishtja (shtokavishte ijekavishte). Identiteti i gjuhës kroate del nga identiteti kombëtar, prandaj, sipas studiuesve kroatë, kroatishte është “çdo gjuhë, nëndialekt apo e folme që është përdorur nga kroatët që nga kohët më të lashta”. Flitet në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë, pjesërisht në Vojvodinë dhe në Banatin e Rumanisë, në Hungari, në Austri, në Sllovaki, ndërsa në diasporë ndeshet në Itali e deri në Amerikë të Veriut e të Jugut në një anë dhe në Australi e Zelandë të Re në anën tjetër. Kroatishtja popullore është shënuar qysh në shekullin XII, ndërsa ajo letrare është zhvilluar nëpër faza deri në Rilindjen kroate në shekullin XIX, kur u përfaqua përfundimisht varietetit me bazë dialektin shtokav. (Kadire Binaj)

KRONISTË OSMANË PËR KOSOVËN (shek. XV-XVII). Kronikat osmane deri në fillim të shekullit XV ishin mjaft primitive, tradicionale, legjendare dhe epike. Vetëm nga koha e sulltan Muratit II (1421-1451) filluan të shkruhen analet me emrin “Historia e derës së Osmani”, të varfra për nga shënimet, por të cilat vazhduan të shkruhen pa ndërprerje. Kronisti më i hershëm osman, në veprat e të cilëve përmendet Kosova në kontekstin politik, ekonomik etj., është Ashik Pasha Zade (1393-1481). Në veprën e tij, pos tjerash, flitet edhe për depërtimin osman në Ballkan, për Betejën e Kosovës (1389), për pushtimin e Novobërdës e të Zveçanit etj. Dursun Beu flet përgjithësisht për vendosjen e sundimit osman në Ballkan. Konstatin Jeniçeri

nga Novobërda shkroi një histori të Perandorisë Osmane, e cila shkon deri në mesin e shekullit XV ku gjejmë shënime edhe për Kosovën. Jacopo de Promontorio de Campis, italian nga Gjenova, i cili ishte në shërbim të Muratit II dhe Mehmetit II deri në vitin 1458 jep shënime mbi gjendjen e financave në Perandorinë Osmane. Ai i radhit xeheroret e Kosovës në mesin e xeheroreve më të rëndësishme të Ballkanit. Mbi vendet ballkanike flasin edhe një sërë kronistësh osmanë të shekujve XV-XVI (Shukrullah, Enver, Oruç, Nishanxi, Hoxha Saadedin, Ali, Sokolzade, Malkoçoğlu, Muhji-ed-din, Mehmed Pasha, Xhelal Zade Mustafa etj). Kronisti Mehmet Neshri i njohur me kronikën “Përshkrimi i botës”, ndër të tjera flet edhe për pushtimin Kosovës, sidomos për pushtimin e Novobërdës dhe Trepçës, ku osmanët gjetën thesar jashtëzakonisht të madh (1455). Kronisti Kemal Pasha Zade (1468-1534), i njohur si Ibni Kemal, la pas vetes një histori të shquar të Perandorisë Osmane, ku flitet edhe për pushtimin e Novobërdës, Trepçës dhe xeheroreve të tjera në ato krahina. Flet edhe për Kaçanikun. Lytfi Pasha (1483-1563) la pas vetes disa vepra, si “Historia e Perandorisë Osmane” dhe “Libri mbi vezirët”. Tevarihu i tij llogaritet në mesin e kronikave më të mira të Perandorisë Osmane. Ky kronist kishte funksione të larta në kohën e sundimit të tre sulltanëve të mëdhenj (Bajazitit II, Selimit I dhe Sylejmanit I Kanuni). Të gjitha burimet pajtohen se ishte me origjinë shqiptare. Kronist i dalluar i gjysmës së dytë të shekullit XVI ishte edhe Hoxha Sadeddin (1536-1599), i njohur me veprën “Kurora e historisë”. Njihet si burim i parë serioz për historinë osmane. Vepra e tij u përkthye në latinisht, gjermanisht, italisht, në turqishten moderne etj. Nga kronistët e shekullit XVII u dalluan sidomos: Ibrahim Peçevi (Peçuj), kronika e të cilit përfshijnë vitet 1520-1639, pastaj Evlija Çelebiu, Katib Çelebi-Haxhi Kallfa etj. Në këtë radhë është i njohur edhe Koçi Mustafa bej, shqiptar nga Korça, i cili në vitin 1631 shkroi një broshurë (risale) mbi gjendjen administrative të Perandorisë Osmane. Më pas vjen Koxha Hysein (?-1649/50), me origjinë nga Sarajeva, në kronikën e të cilit gjejmë shënime të rëndësishme edhe për historinë shqiptare. Pastaj: Abdullah Mostarasi, me origjinë bohshnjake, i cili përpiloi në vitin 1667 regjistrin e kadillëqeve të pjesës europiane të Perandorisë

Osmane; Ali Çausht nga Sofja, i cili në kronikën e tij flet mbi organizimin timar gjatë shekullit XVII, ku ndër të tjera jep shënime edhe për trojet shqiptare; Ajni Ali (1610) flet për rregullimin administrativ të sanxhaqeve të Kosovës; Naima Mustafa efendiu (1655-1716) shkroi historinë e Perandorisë Osmane në 6 vëllime, ku gjejmë shënime interesante për historinë shqiptare; Defterdar Sari Mehmed Pasha (?-1717), Silahdar Findiklili Mehmet aga (1658-1723) dhe Mehmed Rashid (?-1735), bashkëkohës dhe dëshmitarë i shumë betejave nga luftërat austro-osmane (1683-1699), të gjithë këta japin shënime të hollësishme edhe për zhvillimet në Kosovë dhe rolin e pashallarëve dhe bejlerëve shqiptarë të sanxhaqeve të Kosovës. (Gazmend Rizaj)

KRONISTËT DALMATË. Marrëdhëniet ndërmjet qyteteve të Dalmacisë me ato të Kosovës zënë vend të rëndësishëm në veprat e kronistëve, hagiografëve dhe të historianëve dalmatë. Njoftimet që ofrojnë kronistët dhe historianët dalmatë përfshijnë një vertikale të gjatë kronologjike dhe disiplina të ndryshme historike. Përveç historisë politike, aty ndeshim edhe aspekte nga historia ekonomike, sociale, kulturore, fetare, nga historia e artit, shkencës, arsimit, shëndetësisë etj. Vend të rëndësishëm kronistët dalmatë i kanë kushtuar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, princërve Balshaj, Dukagjini dhe në këtë kontekst edhe lidhjeve të tyre me Kosovën. Të tilla njoftime ndeshim te Anonimi i Raguzës (*Annales Ragusini Anonymi*, shek. XV), Juraj Shizhgoriq (*Georgius Sığoreus/Sibenicensis Dalmata*, 1445-1509?), Ludovik Çerva (*Ludovicus Cerva Tubero*, 1459-1527), Nikollë Ranjini (*Nicolai de Ragnina*, rreth 1490-1577?), Matija Vlaçiq (*Flacius Illyricus*, 1520-1575), Euzeb Kaboga (*Eusebius Caboga*, gjysma parë, shek. XVI-1594), Serfin Razi (*F. Serafino Razzi*, 1531-1611), Vinko Pribojeviq (*Vincentius Priboevius*, mesi shek. XV-pas vitit 1532), Mauro Orbini (rreth 1550-1614), Jak Llukari (*Giacomo di Pietro Luccari*, 1551-1615), Gjon Gondoli (*Joannis Gundulae*, 1589-1638), Ivan Luçiq (*Johannes Lucius*, 1604-1679), Gjon Resti (*Junii Restii*, 1669-1735) etj. Të dhënat që i ofrojnë kronistët dalmatë për periudhën historike para shek. XIII nuk janë aq të sigurta. Mirëpo, kur i trajtojnë çështjet që i referohen shek. XV-XVI, dhe në këtë kontekst

dhe historinë e Kosovës, nëse plotësohen me burimet zyrtare, mund të konsiderohen si burime historike të rëndësishme. (Jahja Drançolli)

KRUSHA E MADHE. Fshat në pjesën jugore të komunës së Rahovecit. Është vendbanim i tipit të dendur. Nëpër këtë vendbanim kalon rruga magjistrale Gjakovë-Prizren. Sipërfaqja e territorit të fshatit është 10.05 km² dhe në të jetojnë 4.473 banorë. Me emrin Krusha është i regjistruar në një hartë austriake të vitit 1689. Gjatë luftës së fundit fshati humbi një numër të konsiderueshëm të popullsisë mashkullore, duke çrregulluar dukshëm strukturën e popullsisë dhe jetën e fshatit Popullsia merret me bujqësi, tregti dhe zejтари. Mbi 90% të territorit të fshatit e zënë tokat bujqësore. Fshati është i njohur për prodhimet cilësore nga perimtaria. Nga objektet e standardit shoqëror fshati ka shkollën 9-vjeçare, shkollën e mesme, stacionin shëndetësor, tregun etj. Është bashkësi lokale, në të cilën gravitojnë vendbanimet: Celinë, Nagacë, Hoçë e Vogël dhe Brestoc. (Idriz Shala)

KRUSHA Visar (1973-). Dramaturg, skenarist, producent. Lindi në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Kaçanik, studimet për dramaturgji i kreu në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (UP). Është autor i dramave: “Kafeneja në udhëkryq”, e cila u inskenua në Teatrin Shqiptar të Shkupit (2003) dhe “Çelësi”, e cila u inskenua në Teatrin “Oda” (2004). Ka shkruar skenarët e serive televizive “Familja moderne” (2006-2008), “Brenda drejtësisë” (2009) etj. Shkroi skenarin dhe bëri regjinë e dy filmave të shkurtër: “Tre minuta vetmi” (2009) dhe “Kaçanikasja” (2011). Në vitet 2003-2008 punoi si asistent në degën e dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve të UP-së. Është producent i filmit të metrazhit të gjatë “Babai” (2015), si dhe anëtar i platformave ndërkombëtare të filmbërësve: “Berlinale Talent Campus” (2010) dhe “Sarajevo Talent Campus” (2010). (Erson Zymberi)

KRUSHEVA. Fshat në jugperëndim të Dragashit, 17 km nga qendra. Shtrihet në luginën e lumit Restelicë, në lartësi mbidetare 1,200 m. Si vendbanim përmendet në defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1530. Është vendbanim i tipit të dendur, me sipërfaqe 18.91 km².

Pjesa dërrmuese e territorit të fshatit është e mbuluar me pyje dhe kullosa, ndërsa pjesa tjetër me ara dhe livadhe. Popullsia merret me blegtori ekstensive, bletari, turizëm etj. Një numër i konsiderueshëm i banorëve kanë emigruar në botën e jashtme. Megjithatë, lëvizja e numrit të popullsisë gjatë shek. XX ka treguar rritje të vazhdueshme. Derisa në vitin 1948 Krusheva kishte 281 banorë, në vitin 2011, ajo arrin në 875 banorë. Është bashkësi lokale në të cilën gravitojnë fshatrat: Restelicë, Zlipotok dhe Gilloboçicë. Një pjesë e madhe e territorit të fshatit ndodhet brenda kufijve të Parkut Kombëtar “Mali Sharr”. Nga objektet e standardit shoqëror fshati ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare etj. (Hasim Kryeziu)

KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE. Deri në mbylljen e teqeve bektashiane nga ana e sulltan Mahmudit II më 1826, Kryegjyshata Botërore Bektashiane gjendej në Haxhi Bektash të Nevshehirit në Turqi. Si të gjitha teqetë bektashiane, ashtu edhe kryegjyshata iu dha në përdorim përkrahësve të rrugës mistike nakshibendie. Në vitin 1925 kryegjyshata u mbyll sërish, me vendimin e Ataturkut për mbylljen e teqeve në Republikën e Turqisë. Në periudhën 1926-1928, Salih Nijazi Dedeu negocioi me baballarët bektashi dhe me qeverinë e Mbretërisë Shqiptare për bartjen e kryegjyshit në Shqipëri. Kështu, në vitin 1929, në kongresin e tretë të bektashinjve të mbajtur në Teqenë e Baba Turanit në Korçë u mor vendimi që Salih Nijazi Dedeu të jetë kryegjyshi i bektashinjve botërorë me seli në Shqipëri. Këtë vendim të kongresit të bektashinjve në vitin 1930 e miratoi edhe qeveria e mbretit Zog. Më pas, me dekret të veçantë të mbretit, Salih Nijazi Dedeu u vendos në selinë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane në Tiranë. Kryegjyshata funksionoi deri në vitin 1967, kur qeveria komuniste ndaloi veprimtarinë e feve në Shqipëri. Në mars të vitit 1990 kryegjyshata rifilloi aktivitetin dhe në krye të saj u vendos Dede Reshat Bardhi. Kryegjyshata botërore e bektashinjve aktualisht e gjendet në Tiranë dhe vazhdon aktivitetin e saj. (Metin Izeti)

KRYENGRITJA ANTIOSMANE E VITIT 1910. Kryengritje që filloi në Kosovë dhe u shtri në tërë territoret shqiptare dhe që u shkaktua

nga masat e pushtetit xhonturk kundër popullsisë shqiptare. Kryengritja shpërtheu në prill të vitit 1910 në trevat e Prishtinës, të Llapit, të Vushtrrisë, të Mitrovicës dhe më pas u shtri në gjithë Kosovën dhe në trevat e vilajetit të Manastirit dhe të Shkodrës. Kryengritja shtroi ndër kërkesat kryesore autonominë e Shqipërisë. Porta e Lartë ndërmoi një operacion të gjerë me forca të mëdha dhe armatim të rëndë, me Shefqet Turgut Pashën në krye. Luftimet kryesore u zhvilluan në fillim të majit në Grykën e Kaçanikut dhe më pas në Grykën e Carralevës (6-11 maj), në Qafën e Morinës dhe në Qafën e Agrit. Me gjithë rezistencën e pjesëmarrësve, kryengritja u shtyp në gjak. Veprimet e kryengritësve nuk ishin të bashkërenditura, atyre u mungonte një udhëheqës për bashkimin e tyre, ndërsa komitetet e fshehta në viset e tjera shqiptare ishin të papërgatitura për organizimin e luftës. Shefqet Turgut Pasha, me pretekstin e çarmatimit të popullsisë, vrau dhe dogji viset kryengritëse, duke burgosur dhe internuar mijëra persona. (Isa Bicaj)

KRYENGRITJA ANTISERBE E VITIT 1913.

Kryengritje e shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, të pushtuar nga Serbia, pas Konferencës së Londrës të vitit 1913. Kufijtë e Shqipërisë të krijuar në vitin 1913 prodhuan pengesa të pakapërcyeshme për shtetin e ri dhe për popullsinë e mbetur përtej kufirit. Kufiri privoi një pjesë të madhe të popullsisë rurale nga qytetet dhe tregjet e veta tradicionale. Në këto rrethana filloi kryengritja shqiptare antiserbe dhe antimalazeziase e shtatorit të vitit 1913. Kryengritja përfshiu një front të gjerë, që nga Ohri, Struga, Kërçova, Dibra, Gostivari, Tetova e deri te Prizreni, Gjakova, Peja, Rugova, Plava, Gucia, Hoti dhe Gruda. Udhëheqësit kryesorë të kryengritësve ishin: Isa Boletini, Elez Isufi, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ramadan Zaskoci, Qazim Lika, vëllezërit Kaloshi dhe Dema, Sefedin Pustina, Mehmet Shpendi, Dedë Gjo Luli, Hysni Curri, Bajram Daklani etj. Numri i përgjithshëm i kryengritësve llogaritej se mund të sillej rreth 12,000. Kufiri i posavendosur u thye pothuaj në të gjitha drejtimet e sulmit. Depërtimi kah Dibra ishte më i fuqishëm. Më 29 shtator 1913 çlirohet Dibra me rrethinë. Ushtria serbe u detyrua të tërhiqej edhe nga Struga e Ohri, për t'u përballur me kryengritësit shqiptarë mbi

Gostivar dhe Tetovë. Çlirimi i disa qyteteve të njohura shqiptare në Shqipërinë Lindore dhe të malësisë veriore kah Gjakova e Prizreni nga ana e kryengritësve e tronditi Serbinë. Ajo dërgoi një ushtri prej 40,000 vetash për ta shtypur kryengritjen, meqë u frikësua nga zgjerimi i saj në tërë hapësirën shqiptare. Pas një lufte të rreptë, kryengritja u shua dhe më pas u ndërmoi një masakër në masë kundër shqiptarëve. Kjo kryengritje hyri në histori si përpjekja e parë më e organizuar e shqiptarëve kundër vendimeve të Konferencës së Londrës. (Xheladin Shala).

KRYENGRITJA ANTISERBE E VITIT 1914.

Kryengritja e dytë e shqiptarëve të Kosovës që kundërshtonin pushtimin dhe aneksimin nga Serbia të tokave shqiptare. Përgatitjet për këtë kryengritje filluan në mars të vitit 1914 në fshatrat midis Malishevës, Therandës, Rahovecit dhe Drenicës. Në fillim kryengritësit kishin synim kryesor çlirimin e Prizrenit me rrethinë, për çka kryeministri serb, Pashiq, urdhëroi që të merren masa të menjëhershme: përforcime ushtarake përgjatë kufirit dhe përreth qendrës së grumbullimit të kryengritësve. Kryengritja filloi në dhjetëditëshin e tretë të muajit mars 1914 dhe luftimet zgjatën deri në javën e parë të muajit prill 1914. Përleshjet midis kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë e xhandarmërisë serbe ishin të ashpra dhe pati të vrarë e të plagosur prej disa qindra vetash në mesin e të dy palëve. Masat preventive të ushtrisë e xhandarmërisë serbe nuk lejuan që kryengritja të përhapej edhe në trevat e tjera shqiptare. Kryengritjes iu bë një rrethim i hekurt nga të gjitha anët. Qendra e luftimeve më të ashpra ishte në fshatin Banjë dhe rrethinë. Ndër udhëheqës të grupeve kryengritëse u dalluan: Sadri Abaz Bytyçi nga Karvasaria, vëllezërit Fetah e Asllan Laci nga Llashkadrenoci dhe Hasan Keçi nga Kotorri i Vushtrrisë. Për ta shuar kryengritjen, qeveria serbe kërkoi ndihmë edhe nga malazezët e vendosur në Dukagjin. Rrethimi i kryengritësve u bë nga Prizreni, Theranda, Hani i Duhlës, Hani i Komoranit, nga Kieva dhe Ura e Shenjtë, me çka nuk u pengua që kryengritja të merrte përmasa më të gjera. Popullsia civile e vendbanimeve të përfshira në luftime u detyrua të zhvendosej në vende më të sigurta, për t'u mbrojtur nga masat e ashpra të pushtuesve serbë. Megjithëse kryengritja nuk pati sukses, jehona e saj i kaloi caqet e territoreve të okupuara nga serbo-malazezët.

Për shkak të masave represive të Serbisë, një pjesë e kryengritësve u detyrua të largohet dhe të strehohet në territorin e Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër u nda në çeta të vogla kaçake për të vazhduar rezistencën. (Xheladin Shala)

KRYENGRITJA ANTISERBE E VITIT 1915.

Kryengritje në të dy anët e kufirit verilindor të Shqipërisë, e cila u përhap nga Malësia e Gjakovës e deri në Qafë Thanë. Qendra e kryengritjes ndodhej në Lumë, në krye të së cilës ishte Hasan Prishtina. Me këtë rast u çliruan shumë fshatra të rrethit të Gjakovës, të Sharrit dhe të Prizrenit. Nga sulmet e kryengritësve, ushtria dhe xhandarmëria serbe u detyrua të tërhiqej deri në Prizren. Përparimi i kryengritësve dhe fitoret e tyre zgjatën një javë, deri në dhjetëditëshin e dytë të muajit shkurt të vitit 1915. Serbia, për të mos u ndodhur midis dy zjarresh, në njërën anë Austro-Hungaria, në anën tjetër shqiptarët kryengritës, zgjodhi të sulmonte shqiptarët. Ajo mblodhi nga të gjitha anët ushtrinë dhe xhandarmërinë e vet dhe sulmoi kryengritësit nga Qafë Thana e deri në Malësinë e Gjakovës. Pas përlëshjeve dhe luftimeve të përgjakshme u shkaktuan humbje në të dy anët. Si qendër më e fuqishme e rezistencës së kryengritësve shqiptarë ishte Zhuri me rrethinë. Kryengritësit u detyruan të tërhiqeshin dhe kryengritja u shua në mbarim të muajin shkurt të vitit 1915. (Xheladin Shala).

KRYENGRITJA E DERVISH CARËS (1843-1844). Kryengritje popullore me karakter çlirimtareperiudhësëRilindjesKombëtareShqiptare. U zhvillua në trevat lindore të Shqipërisë



KRYENGRITJA E DERVISH CARËS

dhe në Kosovë në vitet 1843-1844 dhe radhitet ndër kryengritjet e para të fillimeve të lëvizjes

kombëtare në Shqipëri. Mori emrin sipas udhëheqësit të saj, Dervish Carës. Si shkak për këtë lëvizje shërbeu pakënaqësia e shqiptarëve të Kosovës ndaj reformave centralizuese të Portës së Lartë, por shtrirja e saj në një hapësirë të gjerë të territoreve shqiptare dhe veçanërisht kërkesat që parashtruan kryengritësit dëshmojnë se ajo synonte një Shqipëri autonome. Kryengritja filloi në Shkup, më 21 korrik 1843, kur shqiptarët kundërshtuan rekrutimin e ushtarëve të rinj dhe hynë në konflikt të armatosur me autoritetet osmane dhe më 1 gusht, me të dërguarin e sulltanit, Hajredin Pashën. Kryengritja u përkrah qysh në fillim nga gjithë popullsia shqiptare e Shkupit, Tetovës, Prizrenit, Kumanovës, Prishtinës dhe Vranjës. Në nëntor të vitit 1843, Dervish Cara mori Gostivarin, ndërsa në fillim të janarit të 1844, pas luftimeve të ashpra që zgjatën tri javë, mori Tetovën. Më pas kryengritësit hynë në Shkup dhe zunë qytetin, përveç kështjellës, ku u ngujuan 1,600 ushtarë turq, të komanduar nga Hasan Pasha. Numri i kryengritësve në Shkup arriti në 10,000 vetë. Në fillim të shkurtit u çlirua Kumanova, ku me Dervish Carën u bashkua edhe popullsia maqedonase, si dhe Presheva, Bujanoci dhe Vranja. Më pas kryengritësit zunë grykën e Kaçanikut dhe e shtrinë lëvizjen në Leskoc dhe në vise të tjera në veri të vilajetit të Kosovës. Në fillim të vitit 1844 kryengritja u përhap në Pejë, Gjakovë, Prizren dhe deri në Shkodër. Gjatë bisedimeve që u zhvilluan atëherë me Portën e Lartë, kryengritësit i kërkuan Stambollit të anulonte ligjin për shërbimin e detyrueshëm ushtarak, të zëvendësonte titullarët osmanë të pushtetit lokal me nëpunës shqiptarë dhe të njihte autonominë e Shqipërisë, në kuadër të Perandorisë Osmane. Porta e Lartë, për të shmangur shpërthimin e një kryengritjeje të përgjithshme, qysh në prill të vitit 1844 kishte përqendruar në Manastir forca të mëdha ushtarake, mbi 32,000 ushtarë, të komanduara nga Omer Pasha, Hajredin Pasha, Daut Pasha etj. Omer Pasha u nis nga Manastiri për të zënë pikat strategjike dhe rrugët që të çonin në Shkup. Më 18 maj kaloi në mësymje kundër kryengritësve në afërsi të Banjës së Katllanovës dhe i detyroi ata të tërhiqeshin drejt Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës. Pas luftimeve të ashpra, që zgjatën nga 18-21 maj, ushtria osmane arriti të merrte Shkupin, ku bëri arrestime të shumta të kryengritësve. Në Shkup u vendos

më 21 maj edhe komandanti ushtarak i Rumelisë, Reshit Pasha. Më 25 maj 1844 ushtria osmane e rivendosi autoritetin e saj në Tetovë, ndërsa në fillim të korrikut, Osman Pasha sulmoi kryengritësit në grykën e Kaçanikut dhe arriti deri në Prishtinë. Prej andej u hodh për të shtypur qëndresën e kryengritësve në Prizren, Pejë, Gjakovë dhe në Shkodër, ku bëri gjithashtu arrestime të shumta. Kryengritja e Dervish Carës u shua pa dhënë rezultatet e pritura. (Nebi Dervishi)

KRYENGRITJA E PËRGJITHSHME SHQIPTARE E VITIT 1912. Kryengritje kundër-osmane për autonominë e Shqipërisë. Shkaqet kryesore që nxitën shpërthimin e kësaj krye-



ngritje ishte gjendja e rëndë ekonomike e shqiptarëve, prapambetja kulturore e arsimore, reaksioni xhonturk, rreziku nga copëtimi i jashtëm etj. Vendimi për organizimin e kësaj kryengritje u mor në Mbledhjen e Taksimit në janar të vitit 1912. Drejtuesit kryesorë të saj ishin: Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe shumë patriotë të tjerë. Qendër e saj u bë vilajeti i Kosovës. Kryengritja shpërtheu në fillim të muajit mars në Rrafshin e Dukagjinit, përkatësisht në afërsi të fshatit Strelc, ku u vranë dhjetëra vetë. Luftime ndërmjet kryengritësve dhe forcave ushtarake osmane u zhvilluan edhe në Racë, Moglicë dhe në Krumë të Hasit, ku kryengritësit i drejtonte Mahmut Zajmi. Shumë shpejt veprimet e grupeve të armatosura kryengritëse u përhapën në të gjitha viset shqiptare. Më 21 prill 1912, në Krasniqë, prijësit e Malësisë së Gjakovës vendosën për bashkimin e forcave kryengritëse në nivel krahinor. Në këtë kohë u shtuan peticionet dhe protestat e shqiptarëve në drejtim të Stambollit zyrtar, por ai nuk iu përgjigj

atyre. Veç kësaj, u shtuan edhe mbledhjet e kuvendet shqiptare, në të cilat diskutohej për artikullimin e kërkesave të shqiptarëve dhe masat për realizimin e tyre. Në fillim të muajit maj, kryengritja u shtri edhe në sanxhakun e Prishtinës. Pavarësisht nga mungesa e financimit, armatimit dhe materialeve të tjera luftarake, numri i kryengritësve në muajin maj arriti në 15,000 vetë. Në Kuvendin e Junikut më 21-25 maj 1912, që drejtohej nga Hasan Prishtina, në të cilin morën pjesë 250 delegatë, u vendos për zgjerimin gjeografik të kryengritjes dhe realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Përpjekjet e Stambollit zyrtar për dështimin e këtij kuvendi nuk patën sukses. Gjatë muajit maj dhe qershor, kryengritja mori shtytje të mëtejshme në viset veriperëndimore të vilajetit të Kosovës. Më 31 maj kryengritësit filluan sulmin mbi Pejën, ku arritën të thyenin pozicionet ushtarake dhe postat e xhandarmërisë osmane. Në fillim të qershorit kryengritësit thyen katër batalione osmane në Qafë të Prushit. Forcat osmane dështuan edhe në rrethimin e Boletinit, me qëllim likuidimin e Isa Boletinit. Në shenjë hakmarrje, autoritetet osmane vranë, burgosën dhe internuan familjet e drejtuesve të kryengritjes, si: Hasan Prishtina, Zejnullah Vuçitërna, Isa Boletini, Xhemal Prishtina, Riza Gjakova, Bajram Curri, Ahmet Gjakova, Mahmut Zajmi, Sali Gjilani etj. Gjendja e brishtë në viset shqiptare shkaktoi edhe revoltën antiqeveritare në ushtrinë osmane. Ndërkohë, kryengritja u shtri edhe në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, si në Zadrimë, Mirditë dhe krahina të tjera. Ajo shpërtheu edhe në krahinën e Dibrës. Gjatë muajit korrik, pas sulmeve të suksesshme të realizuara nga kryengritësit në vilajetin e Kosovës, erdhi deri te çlirimi i qyteteve, si: Gjakova, Prishtina, Pazari i Ri, Tetova, Mitrovica, Vushtrria, Ferizaj, Gjilani etj. Kryengritësit u mirëpritën nga popullsia nëpër çdo qytet të çliruar. Ata liron të burgosurit dhe larguan prej administratës nëpunësit e funksionarët osmanë. Repartet ushtarake osmane u tërhoqën dhe u strehuan nëpër kazerma të ushtrisë. Kontrollin mbi administratën e morën drejtuesit e kryengritjes, të cilët formuan edhe këshilla lokale. Kjo situatë e krijuar reflektoi edhe në gjendjen politike në Stamboll. Qeveria e re e drejtuar nga Ahmet Myftar pasha nuk pranoi përkujtesën e drejtuesve të kryengritjes për autonominë e Shqipërisë, por vendosi të dërgonte në

Kosovë një komision qeveritar për të biseduar me drejtuesit e kryengritjes. Më 1 gusht ky komision, i drejtuar nga Ibrahim Pasha, arriti në Prishtinë. Kërkesa e Hasan Prishtinës para këtij komisioni që Perandoria Osmane të njihje autonominë territoriale dhe administrative të Shqipërisë nuk u pranua, prandaj dështuan edhe bisedimet. Për shkak të orientimeve të ndryshme që ekzistonin ndërmjet forcave të Kryengritjes, Hasan Prishtina riformuloi kërkesat e përgjithshme të shqiptarëve. Në Kuvendin e Ferizajt, më 6 gusht, ai ia paraqiti 14 pika përfaqësuesve të këtij kuvendi, të cilat kishin përmbajtje të reduktuar, krahas kërkesave autonomiste të Kuvendit të Junikut. Më 9 gusht, Hasan Prishtina ia paraqiti 14 kërkesat komisionit qeveritar dhe kërcënoi se nëse ato nuk pranoheshin brenda dy ditësh, kryengritësit do të marshonin drejt Shkupit. Kryengritësit nuk morën asnjë përgjigje, prandaj hynë në Shkup më 11 gusht. Çlirimi i Shkupit e detyroi qeverinë në Stamboll që më 18 gusht, me disa nuanca, të pranonte 14 pikat e Hasan Prishtinës. Kështu, më 20 gusht kryengritësit u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Sikurse shtetet ballkanike, po ashtu edhe Fuqitë e Mëdha nuk i dhanë mbështetje kryengritjes shqiptare. Menjëherë pas saj shqiptarët nisën të merrnin në dorë administrimin e vendit. Kryengritja e përgjithshme kundërosmane e vitit 1912 ndihmoi ndjeshëm procesin e pavarësimit të Shqipërisë. (Jusuf Bajraktari)

KRYENGRITJA E RRAFSHIT TË DUKAGJINIT (1919). Kryengritja më e fuqishme shqiptare në Kosovë kundër pushtetit serb, për çlirim e bashkim kombëtar, në periudhën midis dy luftërave botërore. Rivendosja e pushtetit serb në Kosovë më 1918 çoi në riorganizimin e qëndresës së armatosur të popullsisë shqiptare. Dhuna e terrori i autoriteteve serbe ngjallën zemërimin në popull dhe u bënë shkak për shpërthimin e një kryengritje të përgjithshme. Konfrontimet e para me armë filluan më 25 tetor 1918. Organizimin e rezistencës së armatosur e kishte marrë përsipër Komiteti i Kosovës. Në krye të forcave kryengritëse u vendos major Hysni Curri. Çetat shqiptare komandoheshin nga udhëheqës të shquar të lëvizjes kombëtare dhe vepronin në bazë të një programi të formuluar nga Komiteti. Në program përcaktoheshin qartë detyrat themelore politike dhe ushtarake të forcave

kryengritëse. Në muajin shkurt të vitit 1919 në Rugovë, Plavë e Guci u luftua frontalisht kundër forcave ushtarake serbe. Kryengritja, edhe pse përfshiu gati tërë Kosovën, ajo njihet më tepër si kryengritje e Dukagjinit. Ndër udhëheqësit kryesorë të saj ishin: Azem Galica, Sadik Rama, Ramadan Shabani, Zef Gjidoda etj. Më 24 prill 1919 në shumicën e territorit të Kosovës u shpërndanë thirrje për kryengritje, që ishte caktuar të fillonte më 6 maj. Po këtë ditë, nën drejtimin e Azem Galicës, mbi 1,000 kryengritës sulmuan Deviqin (qendër administrative) dhe më vonë forcat serbe në fshatrat Rezallë dhe Kopiliq. Në të njëjtën ditë kryengritja filloi në nahijen e Pejës; në Llapushë, nën udhëheqjen e Sadik Ramës, Ramadan Shabanit, Beqir e Zeqir Rexhës; në Rugovë nën udhëheqjen e Kerit të Sadri Bardhit; në Llap nën udhëheqjen e Ramë Vllasës, Hys Popovës, Osman Pollatës, Sahit Shajkovcit etj. Pjesa më e madhe e territorit të Drenicës, e Llapit, e Llapushës dhe e Dukagjinit u çlirua nga kryengritësit, të cilët vendosën pushtetin e tyre. Pothuajse gjatë tërë kohës së kryengritjes, shtabi kryesor i kryengritjes ishte i vendosur në fshatin Sverkë të Gashit, prej nga drejtoheshin operacionet. Nga mesi i majit në Kosovë numëroheshin rreth 10 mijë kryengritës. Në mungesë të materialit të duhur luftarak, ushqimit dhe për shkak të bombardimeve me topa nga ushtria jugosllave, nga fillimi i qershorit kryengritja filloi të bjerë nga intensiteti. Çetat çlirimtare pjesërisht u shpërndanë në grupe të vogla nëpër male, e pjesërisht u detyruan të largohen dhe të vendosen në Shqipëri.

Në Kosovë gjatë kryengritjes së vitit 1919 u vranë 12,291 veta dhe u dogjën 5,345 shtëpi. Pavarësisht nga dëmet e mëdha, qëndresa e armatosur në forma të ndryshme vazhdoi deri në vitin 1941. (Lush Culaj).

KRYENGRITJA E VITEVE 1072-1073. Njëra ndër kryengritjet e popullsisë vendëse kundër pushtetit bizantin, që u zhvillua në territorin e sotëm të Kosovës, të Maqedonisë dhe të Serbisë. Qendër e kryengritjes do të shpallet Prizreni, për t'u shtrirë edhe më gjerë në pjesë të ndryshme të Ballkanit. Në krye të kryengritjes ishin caktuar Kostantin Bodini dhe Gjergj Vojteku. Shkak i kësaj kryengritjeje ishte jeta e vështirë dhe sistemi i rëndë i taksave feudale në rajonet e sunduara nga Bizanti. Kryengritësit iu drejtuan për ndihmë sundimtarit të Dioklesë, Mihail Bodinit, i cili pranoi kërkesën e tyre dhe ua dërgoi

të birin, Kostantin Bodinin. Sipas kronistit dhe strategut bizantin Niqifor Brieni nga viti 1072 deri më 1075 Bodini udhëhoqi ushtrinë kryengritëse, e cila kishte shkatërruar Ilirikun. Së fundi Bodini kishte arritur në qytetin e Prizrenit (1072), i shoqëruar nga ushtaraku Petrillo, me rreth 300 luftëtarë. Kryengritësit, së bashku me disa feudalë nga Shkupi, e shpallën Bodinin për perandor me emrin Petri III. Shpallja për perandor bullgar u referohej edhe lidhjeve që Bodini kishte me familjen e perandorit Samuil. Ndonjë burim i kohës e quante atë stërnip të tij. Pas kurorizimit të Bodinit në Prizren, ushtria ishte ndarë në dy pjesë: Kostantin Bodini me një pjesë të ushtrisë vepronte në luginën e Moravës dhe i drejtohet qytetit të Nishit. Pjesa tjetër e ushtrisë, nën udhëheqjen e vojvodës Petrillo operonte në luginën e Vardarit, deri në Ohër dhe Devoll. Gjergj Vojteku qëndroi në Shkup. Komandanti Petrillo kishte marrë nga Bizanti disa qytete: Ohrin, Devollin, si dhe disa qendra në Shqipërinë Lindore. Në afërsi të Kosturit, Petrillo u thye nga forcat bizantine dhe u detyrua të tërhiqej në Diokle, përkatësisht në Zetë. Derisa forcat e Bodinit vepronin në trevën e Moravës, forcat bizantine kishin rrethuar Shkupin dhe e detyruan Vojtekin të dorëzohet. Kronikat e kohës dëshmojnë se Bizanti e kishte shndërruar territorin e Kosovës në një zonë strategjike ushtarake, duke penguar tërheqjen e Bodinit për në Diokle. Petri së bashku me Vojtekin u mundën dhe u burgosën nga forcat bizantine. Sipas kronistit bizantin, Jan Skylica, "Perandori u deturua të rrethonte fortifikatën e Prizrenit dhe pasi kishte arritur ta merrte atë, bëri ployë mbi kryengritësit; po ashtu plaçkiti çka i doli përpara"

Përveç Prizrenit, pushteti bizantin u rivendos edhe në vise të Maqedonisë dhe Shqipërisë Lindore, duke i shkatërruar me këtë rast fortifikimet e kryengritësve. Me gjithë rezistencën fillestare në Kosovë, Bodini u zu rob dhe u burgos në vendin e quajtur Paun, në pjesën jugore të Kosovës. Më pastaj, që të dy të burgosurit u dërguan në Konstandinopojë. Në rrugë e sipër Gjergj Vojteku vdiq, ndërkaq Bodini fillimisht u burgos në fortifikatën e Konstandinopojës, pastaj u internua në Antioki dhe më vonë, me ndërhyrjen e babait të tij, u lirua dhe u kthye në Diokle. Kjo kryengritje bëri që territori i sotëm i Kosovës dhe popullata vendore e saj të bëhet një faktor i rëndësishëm i ngjarjeve politike në Bizant, duke vënë në pah

rëndësinë gjeostrategjike dhe rolin e Prizrenit si qendër ekonomike, politike, fetare e kulturore të Bizantit. (Muhamet Mala)

KRYENGRITJA E VITIT 1893. Kryengritje kundër pushtetit osman, që u organizua në rrethinat e Pejës dhe të Gjakovës. Në ballë të kryengritjeve u vunë prijës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si Haxhi Zeka dhe Bajram Curri. Kryengritja nuk arriti të merr përmasa të gjera, por mbeti në kuadrin e një kryengritjeje lokale, pavarësisht se u përkrah edhe nga prijës popullorë dhe udhëheqës lokalë në zona dhe kaza të tjera të Kosovës. Autoritetet osmane arritën shumë shpejt ta shuajnë kryengritjen. Pushteti ndërmori masa ndaj kryengritësve dhe drejtuesve të saj. Haxhi Zeka u thirr në Stamboll, gjoja për të njoftuar autoritetet osmane me kërkesat e shqiptarëve, por u arrestua dhe u mbajt në burg për disa vjet. Pas shuarjes së kryengritjes në Pejë dhe Gjakovë, kryengritja u zhvendos në krahinën e Lumës. Rreth 3,000 kryengritës lumjanë sulmuan repartet ushtarake osmane dhe iu drejtuan qytetit të Prizrenit, si qendër e sanxhakut. Ndër kërkesat e kryengritësve të karakterin politik dhe ekonomik, ishte edhe kërkesa për shkarkimin e mytesarrrifit. Valiu i Kosovës, duke dashur ta qetësojë revoltën, e shkarkoi mytesarrrifin e Prizrenit. Ky veprim i qetësoi përkohësisht masat e kryengritësve, por nuk arriti t'i kënaqë shqiptarët, të cilët kërkonin më shumë të drejta ekonomike, shoqërore dhe politike. (Frashër Demaj)

KRYENGRITJA KUNDËROSMANE E VITIT 1911. Kryengritje çlirimtare për autonominë e Shqipërisë. Njëri nga shkaqet e kësaj kryengritjeje ishin masat drastike të qeverisë së xhonturqve në Shqipëri. Dhuna e pushtetit osman krijoi veçanërisht në Malësi një situatë të rëndë për popullatën shqiptare, si në planin e të drejtave politiko-kulturore, ashtu edhe në planin ekonomik-shoqëror. Kryengritja filloi më 23 mars dhe u shtri në të gjithë Hotin, Grudën e Kelmendin si dhe në Shkrel e Kasttrat. Drejtimin e saj e mori një komitet i formuar në Podgoricë, i cili hyri në lidhje edhe me komitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Kryengritësit malësorë që udhëhiqeshin nga Ded Gjo Luli, Mehmet Shpendi, Nikë Gjelosh Luli, Gjekë Marash Gjeloshi, Kolë Dedë Luli etj., çliruan Tuzin dhe arritën deri afër

Koplikut. Luftime të ashpra u zhvilluan rreth malit Deçiq. Kundër kryengritësve qeveria e Turqve të Rinj dërgoi forca të mëdha, nën komandën e gjeneralit Shefqet Turgut Pasha. Megjithatë, kryengritësit i mbajtën pozitat e zëna përgjatë lumit Cem dhe në majat e Selcës, për muaj të tërë, duke zhvilluar luftime të ashpra. Në këto luftime morën pjesë edhe gratë, si Tringë Smajlja e Grudës e Norë Luli e Hotit. Pasi Shefqet Turgut Pasha shpalli amnistinë për kryengritësit që do të dorëzoheshin brenda 10 ditëve, duke premtuar caktimin e një fondi për ndërtimin e shtëpive të shkatërruara nga operacionet ushtarake, përfaqësuesit e kryengritësve u mblodhën në Greçë, ku më 23 qershor miratuan një memorandum (Memorandum i Greçës) drejtuar Portës së Lartë e Fuqive të Mëdha, me kërkesën e parashtruar në emër të mbarë kombit për njohjen e Shqipërisë si provincë autonome. Edhe përkundër propagandës së qeverisë xhonturke dhe të shteteve fqinje se kryengritja kishte karakter lokal, fetar dhe antireformë, karakteri kombëtar i memorandumit dhe lufta e malësorëve i demantonin fuqishëm trillimet e këtilla. Se kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës zhvillohej në kuadër të një lëvizjeje të përgjithshme kombëtare e dëshmon edhe fakti se ajo u shtri edhe në krahina të tjera të vendit. Kërkesa të përafërta me Memorandumin e Greçës iu paraqitën qeverisë turke edhe nga mbledhja e Cepos, e Urës së Drashovicës dhe e Qafës së Sinjës. Megjithatë, gjendja e vështirë që u krijua, bëri që krerët e kryengritjes të nënshkruanin marrëveshjen me autoritetet turke në Podgoricë, në gusht të atij viti. Me këtë marrëveshje shqiptarëve u njiheshin disa të drejta të kufizuara. Edhe kryengritësit e Shqipërisë së Jugut nënshkruan një marrëveshje të njëjtit në Tepelenë. Edhe pse kryengritja e vitit 1911 nuk u kthye në kryengritje të përgjithshme, ajo ishte një hap i rëndësishëm që çonte shqiptarët drejt qëllimit përfundimtar, shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912. (Teki Kurti)

KRYENGRITJET ANTIOSMANE (1839-1885). Kryengritje e të gjitha zonave shqiptare, të orientuara kundër reformave të Tanzimatit, të cilat forconin pushtetin osman përmes taksave dhe masave të tjera shtrënguese për popullsinë vendëse. Në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare reformat u shpallën zyrtarisht në vitin 1843. Edhe para shpalljes së

reformave në vjeshtën e vitit 1839, në Prizren kishte shpërthyer kryengritja kundër Ismet Pashës. Kryengritësit rrethuan Ismet Pashën dhe kërkuan sigurimin e një autonomie të sanxhakut dhe qeverisje nga vetë shqiptarët. Gjatë viteve 1843-1844, Kosova dhe trevat lindore shqiptare u bënë vatër e njëres prej kryengritjeve më të fuqishme kundër pushtetit osman, e cila, sipas emrit të udhëheqësit të saj, është quajtur Kryengritja e Dervish Carës. Kryengritja filloi në korrik-gusht të vitit 1843, me ardhjen e forcave osmane nën drejtimin e Hajredin Pashës. Banorët e Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit, Shkupit, Tetovës dhe Gostivari etj., rreth 10,000 kryengritës të armatosur ngritën krye dhe hyn në Shkup, çliruan qytetin dhe formuan një këshill të kryengritjes. Në fillim të vitit 1844 kryengritja u shtri në Pejë, në Gjakovë, në Prizren e deri në Shkodër, ndërsa në gjysmën e vitit 1844 përfshiu të gjitha trevat shqiptare, nga Manastiri e Ohri në jug, e deri në skajet veriore e verilindore të Kosovës. Gjatë kryengritjeve garnizonet ushtarake turke ishin detyruar të mbylleshin në kështjella dhe qytete. Ushtria osmane, e udhëhequr nga Omer Pasha, pas luftimeve të ashpra me kryengritësit, pushtoi Tetovën, Gostivarin, Kumanovën, Preshevën, Bujanocin dhe Vranjën, ndërsa në korrik të vitit 1844 mori të gjitha qendrat, nga Kaçaniku e deri në Prishtinë. Pastaj filloi shtypjen e kryengritjes në Prizren, në Gjakovë, në Pejë dhe Shkodër. Në maj të vitit 1845, rreth 2,000 malësorë të krahinës së Gjakovës ngritën krye kundër qeveritarit të saj dhe e detyruan të largohen për në Prizren. Kryengritja u përhap shpejt në viset malore të Rekës, të Bytyçit, të Gashit, të Tropojës dhe të Krasniqës, nën udhëheqjen e Binak Alisë dhe Sokol Ramës. Rreth 8,000 kryengritës sulmuan në maj të atij viti Gjakovën dhe çliruan qytetin. Rezistenca e kryengritësve e detyroi Portën e Lartë që ta shtyjë për një kohë zbatimin e reformave. Në shtator të vitit 1866, në fshatin Ostrozub dhe Polluzhaj në nahijen e Prizrenit, fshatarët u ngritën kundër kërkesave të pushtetit osman. Në të njëjtën kohë ishin ngritur edhe fshatarët në rrethinat e Gjakovës dhe Pejës. Në vitin 1869 në krahinën e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës u bë një kryengritje kundër zbatimit të taksave. Në sanxhakun e Prizrenit, në krahinën e Pejës, Gjakovës dhe Malësisë

u bënë rezistencë të fortë pushtetit osman, duke mos paguar tatimet dhe duke refuzuar rekrutimet për ushtrinë osmane. Gjatë viteve 1874-1875 ngritën krye populli i Pejës. Pas thyerjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Porta e Lartë filloi zbatimin e reformave në krahinat shqiptare. Në vitin 1884, Prizreni me rrethinë u ngrit sërish në kryengritje, kur mytesarifi Ibrahim Pasha filloi t'i zbatonte reformat. Në vitin 1885 shpërtheu kryengritja në krahinat e Kosovës, në Prizren, në Gjakovë, në Ferizaj, në Llap dhe në Lumë etj. kundër rritjes së taksave dhe mbledhjes së armëve. (Luan Tetaj)

KRYEZIU Bahtijar (1949-). Gjuhëtar. Lindi në Rogaçicë të Kamenicës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i mbaroi në Prishtinë (1974), ku kreu edhe studimet pasuniversitare dhe mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës (1998). Punoi si mësimdhënës në shkollën e mesme në Kamenicë dhe në Gjilan (1975-1977). Nga viti 1979 deri më 2002 ishte ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan, kurse nga viti 2002 punon në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit, qendra në Gjilan. Mori pjesë me kumtesa në konferenca, simpoziume e tubime të tjera shkencore dhe botoi artikuj në gazeta, revista, në botime të veçanta. Botoi një sërë veprash nga fusha e onomastikës, gjuha e sotme etj. (Agnesa Hasimja)

KRYEZIU Ceno bej (1895-1927). Figurë politike kontraverze, ministër i Punëve të Brendshme të Shqipërisë. Biri i Riza bej Kryeziut, lindi në Gjakovë. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike iu priu trupave shqiptare që luftuan kundër Malit të Zi, ndërsa në vitet 1912-1914 ishte nënprefekt në Krumë, ku ishte edhe komandant i trupave kufitare. Në vitin 1915 luftoi kundër forcave austro-hungareze, kur edhe u zu rob. U akuzua edhe për plaçkitjen e Manastirit ortodoks të Deçanit. Në vitin 1922 u martua me Nafijen, motrën e Ahmet Zogut, kur edhe u zgjodh kryetar i komunës së Gjakovës. Në vitin 1924 e ndihmoi Ahmet Zogun të arratiset në Jugosllavi dhe të vendosë kontakte me zyrtarët e Beogradit. Në dhjetor të vitit 1924 trupat e tij u ndeshën në betejë me forcat e Bajram Currit, të cilin e ndoqi derisa ky u vra (mars 1925). Nga prilli e deri në shtator të vitit 1925 ishte ministër i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, post për të cilin

iu desh të hiqte dorë nga shtetësia jugosllave. Mbahet mend për ndjekjen e egër që u bëri përkrahësve të kryengritjes së qershorit të vitit 1924, të cilët kishin mbetur ende në Shqipëri. Në vitin 1926 u emërua ambasador i Shqipërisë në Beograd, ndonëse autoritetet jugosllave vazhdonin ta konsideronin si qytetar jugosllav. Në shkurt të vitit 1927 u emërua ambasador i Shqipërisë në Çekoslovaki. Në tetor të atij viti, pak pas arritjes në Pragë, u vra nga Alqiviadh Bebi. (Kosovar Basha)

KRYEZIU Ekrem (1943-). Regjisor filmi e teatri, skenarist dhe dramaturg, mësimdhënës universitar. Lindi në Pejë, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Nisi studimet në Zagreb, por i vazhdoi në degën e dramaturgjisë të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Beogradit. Fillimisht punoi si aktor në Teatrin Popullor Krahinor, më pas ishte gazetar dhe përkthyes në gazetën "Rilindja". Një kohë punoi në Televizionin e Beogradit,



EKREM KRYEZIU

në programin në gjuhën shqipe, pastaj në Televizionin e Prishtinës, folës, realizator, skenarist, redaktor, regjisor dhe producent. Bëri regji në teatër dhe në film. Ishte ndër regjisorët e parë të Kosovës në produksionin e "Kosovafilmit". Pas demonstratave të vitit 1981 u arrestua dhe u dënua me tetë vjet burg. Në kuadër të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës është njëri nga themeluesit e degës së dramaturgjisë (1996). Më 1979 bëri regjinë e filmit artistik me temë nga Lufta e Dytë Botërore "Kur pranvera vonohet", ndërsa një vit më vonë filmin "Gjurmë të bardha", që të dy në produksion të "Kosovafilmit". Më pas, në vitet '90 dhe pas vitit 2000 realizoi një numër filmash dhe dramash televizive: "Buka", "Buka e hidhur", "Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna", "Rruga pa kthim", "Viktimat e Tivarit", "Epoka para gjyqit", "E kafshoja terrin", "Kodi i jetës", pastaj filmat dokumentarë: "Dhe dita e dasmës erdhi", "Tepricat", "Përtej bunarëve", "Një lindje", "Luftëtarët", "Dita e mërgimtarëve", "Po vdes Rugova", "Kronika nga Shqipëria", "Sofra", "Të ngjuarit", "Pikë e gur", "Mallkimi i kuajve", "Piktori Muslim Mulliqi". Dramat e tij "Epoka para gjyqit", "Të ngjuarit", "Korridorët e tmerit", "Komploti Ilir", "Përplasjet", "I biri i Rozafës", "Binjak Siamez" u inskenuan në të gjitha teatrot

shqiptare, në Prishtinë, në Tiranë, në Gjakovë etj. Bëri regjinë edhe të një sërë shfaqjesh teatrale në Teatrin Popullor Krahinor, përkatësisht në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin e Gjakovës etj. Për punën artistike regjisoriale mori një sërë çmimesh dhe mirënjohjesh. (Gani Mehmetaj)

KRYEZIU Faton (1979-). Piktor. Lindi në Prizren. Kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindje, ndërsa studimet në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, drejtimi i pikturës (2002). Hapi disa ekspozita personale: “Hani i 2 Robertëve”, Prishtinë (2001 dhe 2002); Ekspozita “Kavaleti”, Galeria e Pallatit të Rinisë, Prishtinë (2004); Galeria e Ministrisë së Kulturës, po në Prishtinë (2004 dhe 2009), pastaj në Pallatin e Kulturës në Tetovë, në Qendrën Universitare të Kulturës në Novi-Pazar, në Galerinë e Arteve të Kosovës në Prishtinë (2011), në Qendrën Europiane për Kulturë në Prizren (2013) dhe në Galerinë Brücke-Legden në Gjermani (2014). Mori pjesë edhe në disa ekspozita të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit. Mori disa çmime dhe mirënjohje. (Irir Muharremi)

KRYEZIU Gani (1900-1952). Luftëtar i rezistencës antifashiste, oficer karriere, vëlla i Ceno beg Kryeziut. Lindi në Gjakovë. Kreu akademinë ushtarake në Sarajevë. Në fillim të viteve ‘20 shërbeu në ushtrinë serbe dhe ishte adjutant i mbretit Aleksandër. Në vitin 1925 komandoi një divizion të vogël artilerie në Shqipëri. Pas kthimit në Shqipëri, pasi Ahmet Zogu ia vrau vëllanë Ceno Begun, u bë armik i tij. Me pushtimin italian të Shqipërisë më 1939, G. Kryeziu iu bashkua krahut të rezistencës. Për shkak të qëndrimit të tij properëndimor dhe kontakteve me qeverinë jugosllave në vitin 1940, forcat britanike u përpoqën ta bindnin të krijonte një lëvizje monarkiste të rezistencës. Nga fundi i vitit 1940 u bënë plane që ai të merrte Kukësin dhe të shpallej kryetar i një qeverie shqiptare kundër interesave italiane, por ky projekt nuk u realizua asnjëherë. Në vitin 1941 u arrestua nga gjermanët, u burgos në Zemun dhe pastaj në vitin 1942 iu dorëzua italianëve dhe u internua në një kamp në ishullin Ventone. Pas kapitullimit të Italisë (shtator 1943) u lirua nga burgu dhe u kthye në Shqipëri. Si kundërshtar i fashizmit, së bashku me 2 mijë luftëtarë iu bëri qëndresë forcave

gjermane. Me forcat e tij kaloi në Kosovë dhe ishte njëri ndër udhëheqësit e rezistencës antifashiste dhe antijugosllave, duke kërkuar të krijohej aleancë me forcat britanike të Ekzekutivit të Opracioneve Speciale (SOE). Organizata që ai drejtonte u shpërbë në fund të vitit 1944. Në janar të vitit 1945 u zu nga partizanët shqiptarë dhe iu dorëzua autoriteteve jugosllave. Gjykata ushtarake e dënoi me 5 vjet burg. Burgun e mbajti në Mitrovicën e Sremit, ku vdiq më 1952. (Kosovar Basha)

KRYEZIU Hevzi (1953-2009). Gazetar. Lindi në Rogoçicë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, të mesmen në Shkup, kurse u diplomua për gjuhë e letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ishte i burgosur politik. Punoi gazetar në Televizionin e Prishtinës deri në vitin 1990. Emigroi në Zvicër dhe për disa vjet ishte korrespondent nga Selia e OKB-së në Gjenevë për Radio-Zagrebën, edicionin në gjuhën shqipe, dhe për Radio Tiranën, Redaksia për Kosovën, si dhe për gazetën “Rilindja”, botimi i Zvicrës dhe i Tiranës. Vdiq në aksident komunikacioni në Gjenevë. (Shaqir Foniqi)

KRYEZIU Ilhami (1921-2006). Profesor. Lindi në Gjakovë, ku përfundoi arsimin fillor. Shkollën e mesme e kreu në Pejë, ndërsa studimet për letërsi të përgjithshme në Padovë dhe Firencë të Italisë. U doktorua në Grac të Austrisë më 1949 me tezën “Mësimi i gjuhëve të huaja në shkollat e mesme”. Në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës punoi nga viti 1966, si mësimdhënës i gjuhës gjermane. U pensionua më 1991 me titullin profesor inordinar. Mbajti ligjërata edhe për lëndën e latinishtes. Shkroi dy tekste mësimore për gjuhën latine, një për nxënësit e shkollave të mesme (1983) dhe një gramatikë të gjuhës latine (1985). Ka publikuar artikuj që kryesisht lidhen me mësimin e latinishtes dhe të gjermanishtes. (Agnesa Hasimja)

KRYEZIU Naim (1918-2010). Futbollist. Lindi në Gjakovë. Si i ri shkoi në Tiranë, ku filloi hapat e parë në lojën e futbollit. Pas pushtimit italian të Shqipërisë (1939) u zbulua nga një profesor i sportit italian, i cili ia propozoi “Romës”. N. Kryeziu iu mundësua të shkonte në Romë ISEF (universitetin sportiv italian) dhe të luante për “Romën”, ku e fitoi titullin e parë

në stinorin 1941/42. Ai luajti për “Gialloross-ët” deri në vitin 1948, kur iu bashkua “Napolit”, ndërsa e ndërpreu futbollin aktiv në vitin 1953. Më pas nisi karrierën e trajnerit, duke u bërë timonieri kryesor i “Romës” për një kohë të shkurtër (1963/64) dhe më pas u bë skaut për këtë skuadër. Vdiq në Romë në moshën 92-vjeçare, në vitin 2010. Ai ishte futbollisti i fundit që ishte ende gjallë, që kishte fituar “Scudetto” e parë dhe historike të Romës. Lojtarët e “Romës”, të cilët atë natë luajtën me “Udinesen”, mbajtën në krahë shiritin e zi, për ta nderuar kujtimin e N. Kryeziut. (Moral Pozhegu)

KRYEZIU Nexhdet (1926-1990). Mjek, pediatër, primarius. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Pejë, Tiranë dhe Shkup. Në Shkup kreu Fakultetin e Mjekësisë (1954). Pas diplomimit u emërua mjek në Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë. Specializoi nga lëmi i pediatriisë (1961) dhe më pas u emërua drejtor i Dispanserit të Fëmijëve në Gjakovë. Nga këtu kalon në Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” si shef i repartit të pediatriisë. Në periudhën 1970-1974 ushtroi funksionin e drejtorit të Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë. Në mbështetje të punës shumëvjeçare si pediatër dhe të punimeve të shumta të publikuara nga fusha e mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, në vitin 1973 mori titullin primarius. U nderua me shumë mirënjohje dhe dekorata. (Mujë Shala)

KRYEZIU Resmije (1945-). Studiuuese e letërsisë. Lindi në Gjakovë. Ndoqi studimet për letërsi në Universitetin e Prishtinës, ku i vazhdoi edhe studimet pasuniversitare. Mbrojti tezën e doktoratës rreth personazhit të gruas në letërsinë shqipe më 1987. Punoi fillimisht si asistente në Institutin e Historisë dhe pastaj si punëtoreshë shkencore në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në degën e letërsisë. Veprat e botuara: “Personazhi i gruas në letërsinë shqipe në mes të dy luftërave botërore” (1988), “Nga Lindja në Perëndim - aspekte të mendimit kritik shqiptar 1913-1944”, “Femina litterarum. Romantizmi, sentimentalizmi, simbolizmi, realizmi, ekspresionizmi” (2008).

Botoi studime, trajtesa dhe recensione nga fusha e historisë së letërsisë shqipe dhe e kritikës letrare. Njëkohësisht mori pjesë në shumë manifestime e konferenca nga fusha e

letërsisë dhe e albanologjisë brenda dhe jashtë vendit. (Kujtim Rrahmani)

KRYEZIU Riza Beg (1847-1917). Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në Gjakovë. Gjatë viteve 1879-1880 mori pjesë në mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë. Pas rënies së Lidhjes së Prizrenit, gjyqi ushtarak në Prizren (1881) e dënoi me internim në Urfë, pastaj dhe në Dijar Bekir. Më pas mori pjesë në kryengritjet e viteve 1910-1912 edhe në Kuvendin e Junikut. Pas dështimit të bisedimeve me qeveritarët osmanë, mori pjesë në mbledhjen e Ferizajt dhe në çlirimin e Shkupit. R. Kryeziu nuk qëndroi konsekuent ndaj programit kombëtar. Pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, iu bashkua Isa Boletinit dhe Bajram Currit. Bashkë me Bajram Currin mori pjesë në organizimin e qëndresës kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Por forcat e tyre dështuan në mbrojtjen e Plavës, të Gucisë dhe të Gjakovës. Pas disfatës ushtarake, R. Kryeziu kaloi në Vlorë. Sërish bashkë me Bajram Currin mori pjesë në organizimin e kryengritjes kundër Serbisë dhe Malit të Zi në Malësinë e Gjakovës dhe në Has. Një grup kryengritësish befasuan ushtrinë serbe në Qafë të Morinës, që kishin për qëllim çlirimin e Gjakovës (6 shtator 1913). Vdiq në Shkodër. (Masar Rizvanolli)

KRYEZIU Rreze (1986-). Muzikologe. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës, drejtimi teoriko-pedagogjik (2005). Më 2009 u diplomua njëherësh në drejtimin teorik-pedagogjik dhe në muzikologji, ndërsa më 2011 përfundoi studimet master për muzikologji në Universitetin e Shkupit. Më 2012 u regjistrua në studimet e doktoratës në muzikologji në Universitetin e Bernit (Zvicër). Merret me shkrime, analiza e kritikë muzikore në tribuna, revista, festivale e simpoziume brenda e jashtë vendit. Është ligjëruese e historisë së muzikës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës nga viti 2009. Ka shkruar artikuj për programe festivalesh muzikore dhe për muzikën artistike të Kosovës në “Groove music online dictionary”. (Besa Luzha)

KRYEZIU Said (1911-1993) Veprimtar dhe luftëtar i rezistencës antifashiste në Kosovë. Vëllai i Gani bej Kryeziut dhe Ceno bej Kryeziut. Në vitin 1933 shkoi në Paris, ku studioi për një kohë të shkurtër për diplomaci në Universitetin e Parisit. U largua nga Franca në vitin 1939


dhe qëndroi në Beograd deri në vitin 1941, ku ndihmoi emigrantët shqiptarë të ktheheshin në Shqipëri për të luftuar fashizmin italian. Në prill 1941, pas një vizite në Shqipëri, u arrestua nga gjermanët dhe iu dorëzua italianëve. U dërgua në kampin Ventone. Në shtator 1943, pas 14 muajsh u lirua dhe në Kosovë u kthye në janar të vitit 1944. Në Pejë, bashkë me vëllezërit e tij dhe Llazar Fundon, iu ngjiten maleve për të luftuar kundër gjermanëve. Ishte në kontakt të ngushtë me misionin britanik në Shqipëri, në veçanti me Xhulian Amerin. Pas përfundimit të luftës u arrestua nga partizanët shqiptarë, por u la i lirë dhe arriti të shkonte në Romë, ku bashkëthemeloi Komitetin Kombëtar për një Shqipëri të Lirë. Në vitin 1959 emigroi në Amerikë. Atje veprroi në kuadër të forcave politike kombëtare me orientim antikomunist. Vdiq në Nju-Jork. (Kosovar Basha).

KRYEZIU Shahin (1920-2001). Piktore. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën fillore në Tiranë. Më 1938 filloi studimet në Shkollën e Vizatimit në Tiranë, me pedagogë A. Buzën dhe O. Paskalin. Pastaj shkoi në Itali (1940-1944), për të studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Torino, te profesor Micheletti dhe më vonë në Firence të profesor Felice Carena. Punoi në gjimnazin e Pejës (1945) pedagog i artit figurativ dhe skenograf në teatrin amator të qytetit. Ishte bashkëthemelues i Shkollës së Mesme të Artit në Pejë (1949). Më 1956 punoi në Gjakovë si arsimtar i artit figurativ, i edukatës teknike dhe skenograf në teatrin amator të qytetit. Gjatë viteve 1977-1978 punoi në Radiotelevizionin e Kosovës, ku realizoi me sukses skenografi për drama, emisione argëtuese ("Akordet e Kosovës"), seri televizive etj. Realizoi skenografitë për filmat artistikë "Era dhe Lisi", "Si të vdiset", "E kafshoja terrin" dhe filmat televizivë "Trimi", "Binarët", "Buka" etj. Gjithë kohën u mor me pikturë, duke pasur vokacion peizazhin. (Blerim Luzha)

KRYEZIU-SLLAMNIKU Laura (1976-). Piktore. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor e të mesëm, studimet për pikturë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (1999). Vokacioni i saj është qeramika. Nga viti 2000 mori pjesë në disa ekspozita të përbashkëta: "Për të mbrojtur ambientin", "Udhëtimi në kujtesë", "Java e dizajnit kosovar", "Bienaleja e dizajnit, "Çmimi Muslim Mulliqi" etj. Jashtë vendit mori

pjesë në ekspozitat kolektive të qeramikës në Rijekë dhe në Zagreb. Mori çmimet "Diplomë nderi" në ekspozitën e qeramikës në Zagreb dhe "Pllakati i argjendtë" në Rijekë. Në "Bienalen e dizajnit" në Prishtinë mori çmimin e parë për qeramikë. (Rexhep Ferri)

KRYPA Fatmir (1942-). Grafist, dizajner grafik. Lindi në Gjakovë. Kreu shkollën fillore në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd (1968). Studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb. Në vitet 1968-1974 ishte profesor në Shkollën Normale në Gjakovë, ndërsa në vitet 1974/75 punoi në TV Prishtina. Nga viti 1975 deri në pension më 2012 ishte profesor i rregullt



FATMIR KRYPA

i lëndës së grafikës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Në këtë institucion kreu edhe funksionin e prodekanit (1978-1980) dhe të dekanit (1987-1989). Kontribuo po ashtu edhe në themelimin e drejtimin të grafikës në Universitetin e Tetovës, ku punoi gjatë viteve 1998-2007. F. Krypa në veprat e tij grafike trajton njeriun dhe motivet e hapësirës kosovare, rritën dhe dramacitetin e saj, të shprehur në mënyrë bashkëkohore, në teknikat e kombinuara të shtypit të thellë. Organizoi shumë ekspozita personale në vend dhe jashtë: në Pejë (1963), në Gjakovë (1967), në Nju-Jork, në Beograd dhe në Novi-Sad (1980), në Shtutgart, Munihi dhe Gogena (1981), në Dubrovnik dhe Varazhdin (1982), në Banjalukë (1991), në Prizren (1992), në Pejë (1996), në Neuchatel, Cyrih, Lozanë (1998), në Prishtinë (2009) etj. Përfaqësoi grafikën e Kosovës dhe të ish-Jugosllavisë në disa shtete të Europës dhe të kontinenteve të tjera dhe ekspozoi në sallone, bienale e triennale të grafikës në shumë vende të botës. Përveç grafikës merret dhe me dizajn grafik. Ilustroi mbi 200 libra për fëmijë dhe të rritur, shumë pllakate të politikës, të kulturës e të sportit. Është fitues i një sërë çmimesh profesionale dhe mirënjohjeve publike. Veprat e tij gjenden në muze e koleksione të njohura. (Basri Mekolli)

KRYPA Hyrije (1945-). Grafiste. Lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe Shkollën e Mesme të Artit

i kreu në Pejë, ndërsa Akademinë e Arteve në Prishtinë (1979). Punoi si mësimdhënëse e artit figurativ në Shkollën e Mesme Ekonomike në Prishtinë, pastaj në Radiotelevizionin e Prishtinës, si ilustratore. Nga viti 1990 deri në pensionim (2010) punoi në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Prishtinë. Është anëtare e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës nga viti 1980. Mori pjesë në një sërë ekspozitash kolektive, ku është prezantuar grafika e Kosovës apo krijimtaria artistike e gruas: Salloni Pranveror i Kosovës në Prishtinë (1981), Grafika Bashkëkohore e Kosovës në Çaçak, në Malmo dhe Londër (1982), në Gllasgou (1983), në Belfast (1985), “Femrat grafiste” në Berlin (1982), Bienalja II e Grafikës në Nju-Delhi (1988), Anali I i Grafikës Bashkëkohore në Slloven Gradec, Femrat krijuese shqiptare në Cyrih (1996) etj. (Basri Mekolli)

KRYQI I KUQ I KOSOVËS (KKK). Institucion i pavarur humanitar i Kosovës. Iniciativat për formimin e Kryqit të Kuq në Kosovë janë të hershme, por themelimi u arrit



NJË AKTIVITET I KRYQIT TË KUQ NË KOSOVË

të bëhej në nëntor të vitit 1945, në rrethana dramatike sociale dhe shëndetësore për popullin e Kosovës. KKK-ja po këtë vit hapi shkollën e parë për infermiere në Pejë. Në vitin 1947 selia e KKK-së kaloi në Prishtinë. Deri në vitin 1991 ishte njëra ndër 8 organizatat e barabarta të Kryqit të Kuq të ish-Jugosllavisë dhe në dy mandate me kryetar dhe sekretar gjeneral nga Kosova. Suprimimi i autonomisë së Kosovës e godet edhe veprimtarinë e KKK-së. Më 31 korrik të vitit 1991, Qeveria e Serbisë suspendoi Kryqin e Kuq të Kosovës. Për pasojë u larguan me dhunë nga puna shumica e punëtorëve shqiptarë, u uzurpuan lokalet,

depot, automjetet dhe u plaçkitën të mirat e tjera materiale që ishin pronësi e KKK-së. Në tetor të vitit 1992 u vendos që KKK-ja të rifillojë punën, por në kushte dhe rrethana tejet të vështira. Gjatë kësaj kohe u mbajtën kontakte të vazhdueshme me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC) dhe me Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC), e kjo rezultoi me hapjen e zyrave të tyre në Prishtinë. Më 1994 u bënë zgjedhjet e lira për KKK-në dhe në Kuvendin e mbajtur më 28 maj, përveç delegatëve shqiptarë, morën pjesë edhe përfaqësues të nacionaliteteve të tjera të Kosovës (përveç serbëve). Në përfundim të Kuvendit ndërhyjnë forcat policore serbe, të cilat shkatërruan dhe plaçkitën çdo gjë, keqtrajtuuan delegatët dhe arrestuan kryetarin e KKK-së. Në periudhën 1992-1998 u punua mbi baza vullnetare, ku pati edhe një pjesëmarrje simbolike të të huajve. Në shkurt 1998 veprimtarët e KKK-së u ofruan ndihmë mjekësore e përkujdesje shëndetësore të zhvendosurve dhe të plagosurve. Sot KKK-ja është e organizuar në gjithë territorin e Kosovës. Organi më i lartë vendimmarrës është Kuvendi apo Asambleja e KKK-së. Veprimtaria e KKK-së është e lidhur ngushtë me emrin e Tahir Jahës (1910-2003), veprimtar, shkrimtar dhe humanist, kryetar i KKK-së në periudhën 1962-1981, kryetar nderi i përjetshëm i Kryqit të Kuq të Kosovës. (Isuf Dedushaj)

KRYQI I KUQ NDËRKOMBËTAR (KOMITETI NDËRKOMBËTAR I KRYQIT TË KUQ, KNKK). Është organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, misioni ekskluzivisht humanitar i së cilës është ta mbrojë jetën dhe dinjitetin e viktimave të luftës gjatë trazirave të brendshme. Kjo organizatë i drejton dhe bashkërendon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe gjatë situatave të konfliktit. Përpiqet t’i parandalojë vuajtjet nëpërmjet promovimit dhe forcimit të së drejtës dhe parimeve humanitare universale. Është themeluar në vitin 1863 (Gjenevë), me iniciativën e Henry Dunant-it, fitues i Çmimit Nobel për Paqe. Simbol i KNKK-së është kryqi i kuq në pëlhurë të bardhë. KNKK-ja është themel i Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (KKGJHK) e themeluar më 1919. KKGJHK-ja është

shoqatë humanitare e pavarur, joqeveritare, me shtrirje në tërë botën, me më se 90 milionë vullnetarë, që mbështesin dhe përkrahin 275 milionë nevojtarë. Sot në botë ka 186 shoqata kombëtare të Kryqit të Kuq ose të Gjysmëhënës së Kuqe. KNKK-ja vepron në Kosovë prej vitit 1993, ndërsa FNKKGJK-ja prej vitit 1994. Që të dyja i kanë dhënë një përkrahje të madhe popullsisë së Kosovës gjatë luftës dhe pas luftës, në ngritjen e kapaciteteve dhe rindëtimin e Kryqit të Kuq të Kosovës. (Xhevat Shkodra)

KRYQI I THYER. Simbol solar, i njohur me emrin svastika. Paraqet diellin në lëvizje dhe simbolizon ciklin e jetës: jetën-vdekjen-ringjalljen. Është i lidhur me kultin e diellit, të përhapur gjerësisht edhe tek ilirët. U paraqit së pari në Mesopotami dhe u përhap në shumë kultura, përfshirë dhe atë ilire. Emrin e mori nga sanskritishtja: "svasti": shëndet, mirësi, gëzim. Dëshmitë e para në Ballkan ndeshen në epokën e neolitit, në kulturën e Vinçës, ndërsa në epokën e bronzit është i shpeshtë në karrocet e Duplajës, Lipci te Risani, Bokën e Kotorrit, në Zhleb të Vishegradit etj. Në trojet ilire u paraqit dendur sidomos pas shek. VI p.e.r. Svastikat janë dhe pjesë e kulturës dardane dhe gjashtë prej tyre gjenden në labirintin dardan të monumentit votiv të Smirës kushtuar Hyjneshës Dardane. (Arben Hajdari)

KRYSHECI. Fshat në juglindje të Pejës, 15 km nga qyteti. Është vendbanim fushor i ndarë në lagje. Në lindje të fshatit janë gjetur mbetje të kulturës materiale, të cilat dëshmojnë për lashtësinë e vendbanimit. Në defterin e sanxhakut të Shkodrës (1582) është i regjistruar me emrin Krusheviça, kurse në sallnamet e vilajetit të Kosovës është regjistruar me emrin Krushefca. Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave janë sjellë 105 familje kolone nga Mali i Zi. Derisa në vitin 1948 kishte 752 banorë, në vitin 2011 fshati ka 1,009 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Ka shkollën 9-vjeçare, stacionin shëndetësor, disa njësi tregtare etj. (Shpend Aga)

KSILANDER Jozef fon (Joseph von Xylander) (1794-1854). Studiues dhe gjuhëtar gjerman. Lindi në Munih, ku mori edhe arsimim ushtarak. Veprimtaria e tij letrare u bë e njohur sidomos me emërimin e tij anëtar i Akademisë së Shkencave Luftarake

të Suedisë dhe me marrjen e titullit Doctor Honoris Causa nga Universiteti i Munihut, si dhe me marrjen e Medaljes së Artë për art dhe shkencë nga mbreti i Prusisë, Fridrih Uilhelm III. Njihet si autor i shumë veprave nga fusha e shkencës ushtarake. Në studimet albanologjike Ksilander njihet si autor i veprës "Gjuha e shqiptarëve ose Shqipetareve" (Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren), botuar më 1835, në të cilën janë paraqitur gramatika e dialektit gegë, përkthimet e hershme të Biblës, fjalorët gjermanisht-shqip dhe shqip-gjermanisht, si dhe shpjegimet e tij rreth prejardhjes së gjuhës shqipe. (Milote Sadiku)

KUBATI Orhan (1937-). Mjek, oftalmolog, profesor universitar. Lindi në Prizren, shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb



ORHAN KUBATI

(1963). Fillimisht punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Prizren, më pas në sektorin e mjekësisë së punës po në Prizren. Specializimin për sëmundjet e syve e filloi në Prizren, e përfundoi në Klinikën e Syve në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd dhe në Francë në vitin 1971. U subspecializua në oftalmologji si strabologu i parë kosovar. Më 1972 u emërua asistent i sëmundjeve të syrit. Studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb, ndërsa temën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1980). Më 1973 u zgjodh asistent i lëndës oftalmologjia në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe po atë vit u emërua kryeshf i Klinikës së Syve. Në vitin 1976 qëndroi për një kohë në Klinikën e Syve në Lion (Francë) dhe në Këln (Gjermani) për perfeksionim profesional. Në vitin 1990 u largua nga puna nga pushteti serb dhe vazhdoi me punë në ambulancën private oftalmologjike në Prizren, por pa u shkëputur nga mbajtja e mësimit në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, ku mori titullin e profesorit ordinar të oftalmologjisë. Pas luftës u kthye në Klinikën e Oftalmologjisë si drejtor dhe shef i lëndës së oftalmologjisë, deri në pensionim. (2002). (Ilhami Goranci)

KUÇI Hajredin (1971-). Politikan, profesor universitar. Lindi në fshatin Arbanë të Pejës.



HAJREDIN KUÇI

Shkollën fillore e mbaroi në Tërstenik të Pejës, të mesmen në Vushtri, kurse Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1999 përfundoi studimet e magjistraturës në Universitetin e Bilkentit në Ankara të Turqisë. Doktoratën e mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në programin e përbashkët me Fakultetin Juridik të Gracit, në fushën e së drejtës ndërkombëtare private. Është profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe ka ligjëruar edhe në Universitetin e Europës Juglindore në Tetovë. Ishte prorektor i Universitetit të Prishtinës (2004-2005), deputet i Kuvendit të Kosovës në katër mandate dhe kryetar i Komisionit Kushtetues të Republikës së Kosovës (2006-2008), si përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Në periudhën 2008-2011 ishte zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë në periudhën 2011-2014, përsëri ministër i Drejtësisë dhe zëvendëskryeministër. Pos punimeve shkencore është autor i teksteve universitare: “E drejta ndërkombëtare private-pjesa e përgjithshme” (2008), “Kolizion i ligjeve” (2007) etj. (Osman Ismaili.)

KUÇI Sedat (1952-). Gjuhëtar, profesor universiteti. Lindi në Suharakë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prizren. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi ruse. Studimet pasuniversitare për gjuhësi i kreu në Prishtinë. Specializoi për fonetikë eksperimentale në Zagreb dhe në Rusi. Deri në vitin 1992 ishte ligjërues i gjuhës ruse, pastaj vijoi mësimdhënien e gjuhësisë së përgjithshme.



SEDAT KUÇI

Më 2003 u doktorua dhe më pas mori titujt përkatës universitarë. Mori pjesë në kongrese, seminare, simpoziume e konferenca me karakter profesional, shkencor brenda dhe jashtë vendit. Ka publikuar dy monografi: “Studimet mbi strukturën e shqipes në BRSS” dhe “Teoria verbotonale dhe sistemi i gabimeve në mësimin e gjuhëve të huaja”. Ka ushtruar funksione me përgjegjësi në institu-

cionet e arsimit të lartë në Prishtinë. (Agnesa Hasimja)

KUÇI Shefki (1976-). Trajner, ish-futbollist. Lindi në Vushtrri. Karrierën e nisi te të rinjtë e “Trepçës”, para se të migronte së bashku me familjen në Finlandë. Si profesionist nisi të luajë në vitin 1995 kur ishte pjesë e ekipit “MP” dhe pas dy edicioneve kaloi te skuadra e njohur “HJK Helsinki” (1997-1999). Në vitin 2001 kaloi në Angli te skuadra “Stocport County” nga Jokeriti dhe pas një edicioni iu bashkua skuadrës “Sheffield Wednesday”. Në edicionin 2005/06 ishte pjesë e skuadrës “Blackburn Rovers”, duke shënuar shtatë gola në 34 ndeshje të zhvilluara në Premier Ligë. Në vitin 2006 kaloi te “Crystal Palace”, pastaj te “Fulham” e “Newcastle United”. Në futbollin anglez qëndroi për më shumë se dhjetë vjet dhe gjithashtu luajti edhe për skuadrat e tjera. Karrierës i dha fund në vitin 2013. Për 11 vjet ishte pjesë e përfaqësueses së Finlandës (1999-2010), për të cilën shënoi tetë gola në 62 ndeshje të zhvilluara. Ka fituar një titull kampioni të Finlandës me “Helsinki”, gjithashtu edhe kupën dhe ligën e kupës së këtij shteti, kurse në vitin 2000 u shpall shënuesi më i mirë i ligës së Finlandës. Është trajner i skuadrës finlandeze “Honka”, drejtimin e së cilës e mori në fillim të vitit 2014. (Arsim Maxhera)

KUÇI Visar (1983-). Violinist. Ndër më të daluarit e brezi të ri në Kosovë. Lindi në Prishtinë, ku kreu Shkollën e Ulët dhe të Mesme të Muzikës (prof. S. Badivuku). Kreu studimet muzikore për violinë në Universitetin “Westfälischen Wilhelms” në Mynster (Gjermani) më 2006. Ndoqi masterklasë të ndryshme, udhëhequr nga violinistë të shquar si: M. Vengerov, T. Papavrami, P. Vernikov, S. Kravtchenko, A. Vinnitski etj. Përpos si violinist, zotëron edhe instrumente të tjera si kontrabasin, kitarën, bas-kitarën, violën, pianon. Nga viti 2008 është asistent i angazhuar te prof. S. Badivuku në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, si dhe koncert mjeshtër në Filarmoninë e Kosovës. Si violinist deri më tani ka pasur paraqitje solistike me ansamble në koncerte e festivale brenda e jashtë Kosove, si në Shqipëri, Maqedoni, Itali, Gjermani, Austri, Belgjikë, Holandë, Bosnjë e Hercegovinë, në Festalet: “Nah Klang” (2002), “Musik Unserer Zeit” (2004), “Klangzeit” (2005), “Münsterlandfestival”

(2006), "Re Musica" etj. (Kristina Palokaj-Përkola)

KUFIJTË E KOSOVËS. Vijë tokësore e cila ndan sipërfaqen shtetërore të Republikës së Kosovës me vendet fqinje. Deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, kufijtë e Kosovës ishin ndërfederalë. Kufiri i Kosovës ka tipare fizike. Në pjesët periferike të Kosovës mbizotërojnë terrene kodrinore-malore. Vija kufitare ka gjatësi prej 700.7 km dhe lidh kryesisht kuotat më të larta të maleve, kodrinave, ndërsa në disa segmente pret luginat lumore, majat dhe qafat. Në pjesën jugperëndimore, Kosova kufizohet me Shqipërinë. Linja kufitare Kosovë-Shqipëri ka gjatësi prej 111.8 km, nga trekufiri Kosovë-Shqipëri-Maqedoni deri te trekufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi. Kjo linjë kufitare është përcaktuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913). Kufiri fillon nga Maja Ksula e Priftit (Sherupa, 2,092 m), vazhdon deri te Maja Kalabak (2,174 m), Murga (2,025 m), përgjatë Pllajës së Shishtavecit, pret lumin e Restelicës, kalon nga Maja e Zezë (1,581 m), bie në luginën e lumit Plava dhe vazhdon në drejtim të Koritnikut (2,395 m). Vija kufitare vazhdon në luginën e Drinit të Bardhë (Vërmicë) dhe kalon në Majën e Pashtrikut (1,988 m). Vazhdon në Malet e Hasit përmes Majës së Kunorës (1,509 m), Majës së Zezë (902 m), Qafës së Prushit (648 m), Qafës së Morinës (592 m), ku kalon në Bjeshkët e Nemuna, duke ndjekur malin Ripa, majën Gusan (2,539 m) në jug të Gjeravicës deri te Trekufiri (2,366 m).

Në pjesën perëndimore dhe veriperëndimore, Kosova kufizohet me Malin e Zi. Gjatësia e vijës kufitare është 78.6 km. Nga trekufiri Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi (2,366 m), kufiri përshkon Bjeshkët e Nemuna, përgjatë majave më të larta dhe rrezave të tyre: Bogiçevica (2,204 m), Maja e Madhe (2,272 m), Maja e Pashës (2,405 m), Maja e Vogël (2,284), Maja e Bajrakut (2,078 m), Leqinat (2,275 m), pret luginën e Bistricës së Pejës, Hajla (2,281 m), Shtedim (1,767 m), Rusoli (2,359 m), Zhleb (2,365 m), pret rrugën për në Qafë Kullë (1,795 m), vazhdon përgjatë Malit Mokna, deri te trekufiri Kosovë-Mali i Zi-Serbi. Në pjesën veriore, verilindore dhe lindore, Kosova kufizohet me Serbinë. Që nga trekufiri Kosovë-Mali i Zi-Serbi, deri te trekufiri Kosovë-Serbi-Maqedoni, gjatësia e vijës kufitare është 351.6 km. Fillon nga Mali Pogled (2,154 m), duke vazhduar përgjatë Malit Mokna, kthehet

kah veriu deri te lugina e Ibrit, vazhdon në veri përgjatë Malit Rogozna, kthehet nga lindja deri te gryka e Ibrit (Jarinje), ku vazhdon në Malin Kopaonik. Kalon përgjatë majës Pançiq (2,017 m) që njëherësh është pika më veriore e territorit të Kosovës. Vazhdon në drejtim të jugut, duke ndjekur majat si Koprivnica (1,636 m), Kulla (1,013 m), Qafën e Perpellacit (876 m), Qafën e Merdarit (650 m), Shkrep (1,122 m), duke prerë rrugën Prishtinë-Medvegjë, në kalimin e Mutivodës, majën Kapia (1,055 m), Tepe (1,080 m), Kitka (1,153 m). Më tutje, vazhdon në luginën e Moravës së Binçës te Gryka e Konçulit dhe ndjek majat më të larta përgjatë Karadakut të Shkupit, duke ndarë Luginën e Preshevës me Kosovën. Më tej vazhdon nëpër malin e Ostrovicës (1,166 m) dhe arrin te Maja e Zezë (1,223 m), që paraqet trekufirin Kosovë-Serbi-Maqedoni.

Në pjesën jugore Kosova kufizohet me Maqedoninë. Nga trekufiri Kosovë-Serbi-Maqedoni deri te trekufiri Kosovë-Shqipëri-Maqedoni vija kufitare ka gjatësi 158.7 km dhe shtrihet kryesisht perëndim-lindje, duke kaluar në kuotat më të larta të Karadakut të Shkupit dhe Maleve të Sharrit. Vazhdon përgjatë malit Kopilaça (1,492 m), lëshohet në luginën e Lepencit në Han të Elezit, duke kaluar në drejtim të vendkalimit të Gllloboçicës dhe majës së Lubotenit (2,498 m). Nga Lubeteni, kufiri i Kosovës ndjek majat dhe qafat më të larta malore të Maleve të Sharrit, duke vazhduar në drejtim të majës së Kullës (2,324 m), Livadhit (2,497 m), Liqenit (2,586 m), Konjushka (2,571 m), Maja e Zezë (2,585 m), Kobilica (2,525 m), Vërtopt (2,555 m), Skarpa (2,474 m), Maja (2,493 m), Rudoka (2,658 m), Vracë (2,536 m) deri te trekufiri Kosovë-Maqedoni-Shqipëri. Megjithëqë kufiri i Kosovës kalon nëpër forma të ndërlikuara gjeomorfologjike, pozita gjeografike e saj në Gadishullin Ballkanik ka mundësuar lidhje të mira me vendet fqinje dhe më gjerë, si dhe kalimin e rrugëve që lidhin brendinë e Gadishullit me detin Adriatik dhe Egje (Ruzhdi Pllana, Vahdet Pruthi)

KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR (KSHP). Është i organizuar në forma të ndryshme që në vitin 1961. Sot KSHP-ja paraqet kujdes themelor shëndetësor, i cili realizohet nga ekipet e mjekësisë familjare. Mjekësia familjare është formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse



NJË QENDËR E MJEKËSISË FAMILJARE NË PRISHTINË

për individët dhe familjet e tyre në formën e kujdesit shëndetësor parësor. Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon KSHP-në si kujdes shëndetësor esencial, në të cilin kanë qasje universale individët dhe familjet në komunitet, në mënyra të pranueshme, përmes pjesëmarrjes së plotë të tyre dhe me një kosto që mund të mbulohet nga komuniteti dhe shteti. KSHP-ja në Kosovë ofrohet në nivel të komunave. Kosova është e ndarë në 36 komuna, ku janë të vendosura institucionet e KSHP-së, përkatësisht qendrat kryesore të mjekësisë familjare (QKMF). Përveç QKMF-ve, në mesin e institucioneve që ofrojnë kujdes parësor shëndetësor bëjnë pjesë dhe qendrat e mjekësisë familjare dhe punktet e mjekësisë familjare. Në nivel vendi funksionojnë 36 qendra kryesore të mjekësisë familjare, 200 qendra të mjekësisë familjare dhe 210 punkte të mjekësisë familjare, ndërsa qendra e mjekësisë urgjente planifikohet të funksionojnë në komunat me më tepër se 150,000 banorë. Me qëllim të ngritjes së përkujdesjes ndaj shëndetit të gruas, Ministria e Shëndetësisë ka autorizuar kuvendet komunale për themelimin e materniteteve, të cilat funksionojnë në kuadër të QKMF-ve dhe janë të pajisura me resurse njerëzore e profesionale. (Merita Berisha)

KUJDESI SHËNDETËSOR DYTËSOR (KSHD). Kujdes shëndetësor në Kosovë që e mundësojnë spitalet rajonale, të cilat janë institucione shëndetësore publike. Ato u ofrojnë pacientëve kujdesin shëndetësor nëpërmjet shërbimeve specialistike, spitalore dhe ambulatorie. Përveç kapaciteteve stacionare, KSHD-ja ofron edhe shërbime të tipit të shëndetit mendor, që janë hapur pas luftës në

disa qendra të vendit. Për zbatimin e nivelit të kujdesit dytësor shëndetësor në Kosovë gjatë viteve të fundit janë përkujdesur 5 qendra mjekësore (spitale rajonale) me këtë ndarje jozyrtare: Qendra Rajonale Mjekësore (QRM) në Pejë (për komunat Pejë, Deçan, Klinë dh Isog), QRM-ja në Gjakovë (për komunën e Gjakovës dhe Junikut), QRM-ja në Prizren (për komunat Prizren, Dragash, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë), QRM-ja në Gjilan (për komunat Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Ranillug, Viti, Partesh, Kllokot) QRM-ja në Ferizaj (për komunat Ferizaj, Kaçanik, Shtërpçë, Shtime), QRM-ja në Mitrovicë të Veriut (Komuna e Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok), QRM-ja në Mitrovicën e Jugut (për Mitrovicën e Jugut dhe Skënderaj), si dhe Spitali i Qytetit në Vushtri dhe Spitali i Graçanicës (për enklavën serbe). Këto institucione shëndetësore iu ofrojnë të gjithë qytetarëve mjekimin stacionar dhe shërbimet specialistike të të gjitha fushave. (Bedri Zahiti)


KUJDESI SHËNDETËSOR TRETËSOR (KSHT). Përfshin shërbimet mjekësore specialistike, edukimin themelor universitar dhe pasuniversitar të kuadrit mjekësor, si dhe hulumtimet relevante shkencore biomjekësore, të cilat kryhen në institucionet përkatëse shëndetësore dhe edukuese. Institucionet e nivelit terciar të kujdesit shëndetësor në Kosovë janë: Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Instituti Kombëtar i Mjekësisë së Punës në Gjakovë dhe Qendra e Telemjekësisë e Kosovës. Të gjitha këto institucione janë të vendosura në Prishtinë, përveç Institutit Kombëtar të Mjekësisë së Punës, i cili funksionon në Gjakovë. Të gjitha institucionet e kujdesit terciar shëndetësor në Kosovë janë edhe baza edukuese dhe kërkimore-shkencore e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Për këtë arsye këto institucione administrohen dhe financohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Historia e themelimit dhe e zhvillimit të këtyre institucioneve është relativisht e re dhe e lidhur ngushtë me zhvillimet shoqërore dhe politike në Kosovë. Me gjithë krizën e rëndë dhe

problemet serioze për punë dhe veprimtari, sidomos në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, roli i këtyre institucioneve për ruajtjen e shëndetit dhe edukimin shëndetësor të popullit të Kosovës ka qenë dhe mbetet shumë i madh. (Avdyl Krasniqi)

KUJUNXHIQ Aleksandër (Aleksandar Kujundžić) (1929-?). Mjek oftalmolog, profesor universitar. Lindi në Rahovec, shkollën fillore e kreu në vendlindje, u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup (1958). Specializimin në lëmin e oftalmologjisë e kreu gjithashtu në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup. Qëndroi jashtë vendit për ngritje profesionale dhe perfeksionim nga lëmi i strabologjisë. Me t'u kthyer hapi qendrën e parë të ortoptisë-pleoptikës në Prishtinë. Studimet pasuniversitare dhe tezën e doktoratës i mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Mori pjesë në disa kongrese, konferenca dhe simpoziume. Ishte profesor ordinar i lëndës së oftalmologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. (Ilhami Goranci)

KUKA Driton (1971-). Xhudist, trajner. Lindi në Pejë. Sportin e xhudos e filloi që në vitin 1981. Ishte gjashtë herë kampion i ish-Jugosllavisë në të gjitha grupmoshat. Pas pavarësimit të sportit të Kosovës, vazhdoi me prezente në arenën ndërkombëtare: fitoi medaljen e bronzit në Kupën e Botës, kategoria A në Budapest, zuri vendin e pestë në Kampionatin European në Athinë etj. Pas karrierës aktive iu përkushtua punës së trajnerit. Nga rezultatet e D. Kukës si trajner veçohen ato me Majlinda Kelmendin, Distria Krasniqin dhe Akil Gjakovën. Të gjithë në këtë sport janë pjesë e ekipit të xhudos "Ippon" nga Peja. D. Kuka pati bashkëpunim të vazhdueshëm me Federatën Shqiptare të Xhudos. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, në lojërat olimpike të vitit 2012 u fitua norma e parë olimpike, duke e përfaqësuar Shqipërinë me garuesen Majlinda Kelmendi. Mori pjesë në Lojërat olimpike verore "Rio 2016" dhe nën drejtimin e tij xhudistja Majlinda Kelmendi, duke e përfaqësuar Kosovën, fitoi medaljen e artë. (Rifat Gjonbalaj)

KUKA Ibrahim (1944-2007). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Guci në Mal të Zi, ku e kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen e kreu në Plavë. Fakultetin Ekonomik e kreu në Universitetin e Beogradit (1968), ku vazh-



IBRAHIM KUKA

doi edhe studimet pasuniversitare. Më 1985 në Universitetin e Prishtinës mbrojti edhe disertacionin e doktoratës për raportet prodhuese vetëqeverisëse në ekonominë jugosllave, me vështrim të veçantë në ekonominë e Kosovës.

Në fillim punoi në Entin për Ekspertiza Ekonomike në Beograd, si organizator i sistemit kompjuterik, më pas si bashkëpunëtor dhe pjesëmarrës në projekte studimore në Institutin Ekonomik të Prishtinës. Në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës u zgjodh profesor për lëndën e teorisë dhe të metodave të vendosjes në ekonomi. Pos në Fakultetin Ekonomik të UP-së ligjëroi edhe në Fakultetin Ekonomik të Tetovës dhe të Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë. Botoi një numër punimesh profesionale dhe shkencore në revista të ndryshme, përfshirë edhe tekstin universitar "Teoria dhe metodat e vendosjes". Ishte pjesëmarrës i shumë konferencave shkencore, vendore dhe ndërkombëtare. (Justina Shiroka-Pula)

KUKA Sherif (1937-1982). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në fshatin Krushevë, komuna e Plavës në Malin e Zi. Shkollën fillore e kreu në Guci, kurse të mesmen e filloi në Pejë dhe e përfundoi në Beograd. Diplomoi në Fakultetin Ekonomiko-Juridik në Prishtinë më 1966, ndërsa u magjistrua në Universitetin e Zagrebit më 1971 në fushën e planifikimit dhe të analizës së ndërmarrjeve. Po në këtë universitet, më 1975 mbrojti disertacionin për aplikimi i metodave operationale në ndërmarrjet e komunikacionit autotransportues. Për shumë vjet ishte drejtor i Institutit Ekonomik në Prishtinë si dhe redaktor i revistës shkencore të këtij Instituti, "Economia". Vdiq në aksident komunikacioni më 1982. Në fushën e shkencave të ekonomisë hapin e parë të rëndësishëm e bëri me librin "Zbatimi i kërkimeve operationale në ekonomi", që ishte ndër botimet e para të fushës së shkencës ekonomike në gjuhën shqipe në Kosovë. Në kuadër të Institutit Ekonomik realizoi shumë projekte shkencore dhe profesionale, që ishin kontribut i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ishte pjesëmarrës i shumë konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit. (Justina Shiroka-Pula)

KUKAJ Rifat (1938-2005). Shkrimtar, përkthyes letrar. Lindi në fshatin Tërstenik të Dre-nasit. Kreu shkollën fillore në vendlindje, kurse Normalen në Prishtinë. Punoi si mësues dhe



RIFAT KUKAJ

drejtor shkolle në fshatin e lindjes, pastaj gazetar dhe redaktor në emis-ionet për fëmijë të Ra-dio Prishtinës, ndërkaq kohën më të gjatë të punës ishte redaktor i botimeve për fëmijë në redaksinë e botim-eve “Rilindja”. I takon

grupit të shkrimtarëve që sollën dhe avan-cuan shprehjen moderne në letërsinë tonë për fëmijë, si dhe bartën barrën e zhvillimit të kësaj letërsie në Kosovë. Numri i veprave të tij është shumë i madh dhe ato janë të të gjitha zhanreve letrare: poezi, tregime, romane, ilu-stracione, humoreska, radiodrama, skeçe etj. E shquan një shprehje e ngrohtë, që vjen si rezultat i frymëzimit të thellë dhe është ko-munikuese me lexuesin, sidomos me fëmijët. Është shkrimtari ynë me numrin më të madh të romaneve për fëmijë, ndër të cilët: “Bardhi e Mirushja” (1968), “Vjolla magjike” (1969), “Lepuri me pesë këmbë” (1971), “Rrasa e zogut” (1975), “Kokërrmeli e pilivesa” (1972), “Gogozheli i Gogozhinës” (1999), “Një verë pa bukureza” (2003), “Zogu i bardhë” (1989) etj. Po ashtu botoi numër të madh përmbledhjesh me tregime, si “Rrëfeja” (1965), “Harmonika e vogël” (1967), “Dylbia e kapedanit” (1973), “Ujku me kamerë” (1988), “Elefanti që flu-turonte” (1997), “Gjiri i Delfinit” (2002) etj., dhe përmbledhje me poezi: “Gjerdani i blertë” (1965), “Vallja e kallinjve” (1967), “Trimnitë e karkalecit” (1967), “Princi i Krujës” (1969), “Fshati i Pishës” (1969), “Çka fshin dhelpra me bisht” (1976), “Deti u bëftë kos” (1980), “Një xinxare lozonjare” (1989), “Pshurrani i gjyshit” (1990), “Ti një kokërr unë një kokërr” (2000), “Ëndrra të trembura” (2002), “Ma jep gishtin e vogël” (2005) etj. Botoi edhe ilustracione për fëmijë dhe u mor edhe me përkthime letrare, sidomos nga gjuha sllovene. Për krijimtarinë e tij letrare iu dhanë çmime dhe mirënjohje të shumt. Vepra e tij letrare është përkthyer në disa gjuhë të huaja. (Xhevat Sylja)

KUKLI Mehmet beu (-1556). Pushtetar i lartë osman dhe themelues vakëfesh. Lindi në fshatin

Kuk të Opojës, në çerekun e katërt të shek. XV. Ishte sanxhakbej i Prizrenit, i Shkodrës dhe i disa sanxhaqeve të tjera të vilajetit të Rumelisë. Në vitin 1538 ka lënë vakëf një varg objektesh të karakterit ekonomik, tregtar, social, edukativ, fetar etj., nga të cilat 14 karvansaraje në rrugën e Dukagjinit dhe në atë të Stambollit, 117 dyqane në Prizren, 50 dyqane dhe disa mullinj në Lezhë, 1 urë në Zhelinë të Tetovës, xhami, namazgjah dhe teqe në Prizren, si dhe disa mullinj, vreshta e kopshte në Prizren e rrethinë. Në vendlindje ngriti një kompleks urban arkitektonik, që përbëhej nga hamami, ujësjellësi, xhamia, mejtepi me bibliotekë, karvansaraji, çezmat e dyqanet, me të cilat Zinova e atëhershme (Bresana e sotme) u zhvillua si kasaba. Edhe fëmijët e tij ishin pjesë e strukturave drejtuese dhe posedues timaresh në sanxhakun e Prizrenit dhe më gjerë. U varros në tyrben pranë xhamisë që e ndërtoi në kasabanë e Zinovës. (Nehat Krasniqi)

KULINA E KAMENICËS. Vendbanim ko-drinor parahistorik dhe i fortifikuar antik. Gjendet 2 km në jugperëndim të Kamenicës, në të majtë të luginës në drejtim të Kalasë së Strezovcit. Kodra ku është ngritur vendbanimi lidhet në trajtë shale me kodrën tjetër, ndërsa rrëzat përshkohen nga lumi i Krilevës dhe i Korallevës. Ka trajtë katërkëndëshi të parregullt dhe shtrihet në dy tarraca. Muret rrethuese veriperëndimore dhe perëndimore janë të drejta, ndërsa lindoret dhe juglindoret kanë trajtë harkore. Kulla katërkëndëshe gjendet në pikën më të lartë të kodrës. Nën fortifikatë, tek “Ura e Çemerëve” (“Ura e Kollarëve”) janë gjetur dy monumente mbivarrrore të periudhës romake, njëri me mbishkrim grek dhe tjetri me atë latin, por lokalitetin e veçon monumenti unik mortar i shek. V-III, i cili flet me gjuhë figurative. Kompozicioni përbëhet nga tri horizonte: 1) komandanti i ndjerë me përkrenare ilire i shtrirë në arkë, femra që prek arkën dhe i paraprin funeralit dhe dy valltare mortore; 2) katër ushtarë me përkrenare ilire që e bartin arkën, një valltare mortore dhe një gjëmëtar; dhe 3) dy gjëmëtarë dhe dy shtazë. Monumenti ka trajtë katërkëndëshe dhe pjesën e epërme gjysmëharkore (0.82 x 1.27 x 0.13 m). (Edi Shukriu)

KULINXHA Ganimete (1962-). Pedagoqe, më-simdhënëse universiteti. Lindi në Prishtinë, ku

kreu edhe shkollën fillore dhe të mesme. Studioi pedagogjinë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe magjistroi dhe doktoroi (2008). Fillimisht ishte pedagoge shkolle në Podujevë, pastaj mësimdhënëse në shkollën speciale në Prishtinë, bashkëpunëtoresh profesionale në Entin Pedagogjik të Prishtinës dhe koordinatore e projektit “Hap pas hapi” në KFOS-KEC (1997-2002). Nga viti 2003 është mësimdhënëse e lëndëve pedagogjike në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë. Interesim të veçantë tregoi për edukimin parashkollor. Publikoi disa punime shkencore-profesionale, ndër të cilët edhe veprën “Komunikimi ndërpersonal në fëmijërinë e hershme sipas programit me fëmijën në qendër” (2015). (Naser Zabeli)

KULTETI BUJQËSOR. Lidhen me kultin e tokës, të bimësisë, të diellit, të hënës, të ujërave etj. Ritet dhe veprimet magjike lidheshin me kohën e fillimit të të mbjellave, të korrjes dhe të shirjes, të mbledhjes së të lashtave në vjeshtë etj. Rreth bujqësisë, më së shumti janë ruajtur ritet e festave të solsticit e të ekuinoksit diellor. Dielli konsiderohej i rëndësishëm për bujqësinë. Fillimi i punës në pranverë lidhej me zgjatjen e ditës dhe me shfaqjen e ditëve me diell. Në disa rajone, para se të fillonte punën, bujku kthehej nga Dielli dhe i falej atij. Gjithashtu kulti i zjarrit ishte i përhapur ndër shqiptarët. Ndezja e zjarreve kultike bëhej për Kalendra, Kërshëndella, Vitin e Ri, për Ujët e Bekuar, për Ditën e Verës, të Shëngjergjit etj. Zjarret kultike në origjinën e tyre të hershme kishin për qëllim t’i jepnin fuqi diellit dhe pastaj dielli t’i jepte forcë prodhimit të ri bujqësor. Zjarret kishin të bënin edhe me vdekjen simbolike dhe ringjalljen e hyjnisë së prodhimit bujqësor. (Anjelina Hamza)

KULTI I DIELLIT. Kult pagan, fazë e zhvillimit të besimit të popuj të ndryshëm. Simboli i diellit manifestohet nga epoka e neolitit, në trajtë rrethi, kryqi dhe më pas kryqi të thyer (svastika: rrugëtimi i diellit). Këto simbole u bënë në shkëmbinj, gurë e enë qeramike dhe me formësimin e kultit edhe në objekte metalike, varëset rrethore e në formë rrathësh koncentrikë, në rripa brezi, mburoja, kallçij etj. Ishte kult kryesor edhe i ilirëve dhe ndeshet më i përhapur tek ilirët e veriut, përfshirë dhe trajtat rrethore të tumave dhe unazave të tyre, të ndërtuara prej gurësh të rrumbullakët të

lumenjve. Amuletet dhe objektet e tjera me simbole të diellit vendoseshin dhe në varre, siç ishin ato prej bronzit nga tuma e Shirokës (shek. VII-VI p.e.r.). Peonët, fis ilir në Maqedoninë e sotme, e adhuronin diellin në formë të një disku të vogël të ngritur në një shtyllë të gjatë, pohon filozofi antik Maksimi (125-185) në veprën “A duhet t’u ngrihen perëndive shtatore”. Simboli i svastikës është i shpeshtë në kohë dhe kultura të ndryshme. Perandori romak, Aureliani, (270-275) me origjinë ilire nga metropoli i Ilirikut Sirmium (Sremska Mitrovica) e zyrtarizoi kultin e diellit në vitin 274 si “padron i ushtarëve”, përkrah kulteve të tjera tradicionale romake dhe dëshmohej në monedhat e perandorëve deri në periudhën e Konstantinit të Madh (306-337). (Arianit Buçinca)

KULTI I GJARPRIT. Kult pagan, i përhapur në forma të ndryshme. Tek ilirët e jugut mbante rol qendror në mesin e kulteve epihorike, por ishte i pranishëm edhe tek ilirët e tjerë. Etnogjeneza e emrit të ilirëve nxirret nga gjarpri, nga hulumtues të ndryshëm, si Otto Gruppe, Karel Ostir, Anton Mayer etj. Mitoграфи Pseudo Apollodori (“Biblioteka” 3, 5, 4) i sheh Kadmin dhe Harmoninë, çiftin nga Teba e Egjiptit, si paraardhës të ilirëve. Këta kishin ardhur në Ilirinë e Jugut në fund të jetës, duke u shndërruar më pas në gjarpërinj dhe duke lindur fëmijën me emrin Ilir. Gjarpri tek ilirët paraqiste shpirtin mbrojtës, mbrojtësin e shenjtë dhe konceptin e paraqitjes së paraardhësve të vdekur në formë të gjarprit. Dëshmitë arkeologjike dhe epigrafike tregojnë se adhurimi i gjarprit ishte i përhapur në Ballkanin Qendror dhe Jugor që në parahistori. Ndonëse objektet e kultit të gjarprit janë dëshmuar në Kosovë nga epoka neolitike (Tjerrtorja, Prishtinë), këto e arritën përsosmërinë e shprehjes artistike në stolitë e epokës së hekurit. Të tillë janë byzlykët në formë gjarpri nga argjendi nga Banja e Pejës (shek. VI-V p.e.r.) apo gilpëra prej argjendi në trajtë omegash, me koka gjarpri në cepa nga Ponošeci (Gjakovë). Byzlykë të ngjashëm janë gjetur edhe në Prilep dhe në Trebenishtë dhe Radolishtë afër Ohrit. Gjarpri në formën hyjnore përkrah ushtarëve dëshmohej në dy pllaka bronzit nga Selca e Poshtme (Shqipëri) dhe në Gostil afër Liqenit të Shkodrës (Mal i Zi). Gjarpri ende konsiderohet si mbrojtës i vatrës dhe i varreve dhe lëkura e tij konsiderohet se sjell fat. (Arianit Buçinca)

KULTI I KALORËSIT. Kult pagan me karakter lokal. Origjina e kultit të kalorësit është kërkuar në Anatoli dhe në Pellgun e Danubit, por dëshmitë më të shumta vijnë nga Mezia e Poshtme, përkatësisht nga Dardania dhe lugina e lumit Marica në Daki. Studiues të shumtë e kanë parë kultin e kalorësit me karakter trakas. Karakteristikë e pllakave votive në Dardani është paraqitja e kalorësit si gjuetar me një qen që sulmon një derr të egër nën një pemë, në të cilën gjendet dhe një gjarpër që e përshkon pemën, ndërsa pranë pemës, në tokë, gjendet altari. Reliev i njëjtë dëshmohet në pllakën votive nga Ulpiana (Graçanicë), e punuar në mermer (25 x 25 cm, shek. III). Pllaka të ngjashme në territorin e Mezisë së Epërme janë gjetur në Katllanovë, Semenisht, Llopat, Bulesofc, Osmakovë dhe Ravnë. Kulti i kalorësit është dëshmuar deri në shek. IV, ndërsa në periudhën bizantine është portretizuar si Shën Gjergji i Lydës (Palestinë). (Arianit Buçinca)

KULTURA BADEN-KOSTOLC. Kulturë e epokës së eneolitit (3000-2700 p.e.r.). U zhvillua si variant i kulturës Baden dhe në vete bashkon grupin kulturor eneolitik të Europës Qendrore dhe të Ballkanit Qendror. Shtrihet në Vojvodinë, Banat, Olteni (kultura Çukuteni), në Hungari, Sllovaki, në Serbinë Veriore, Kroacinë Veriore (Sllavoni, kultura Sopot), në Bosnjën Veriore (kultura Kakanj) dhe territorialisht është më e gjerë se kultura Baden. U zbulua nga M. Vasiq (1906) dhe si e tillë u identifikua nga V. Millojçiçiq e M. Garashanin. Ekonomia mbështetej kryesisht në bujqësi dhe blegtori e më pak në gjueti e peshkim. Vendbanimet janë kryesisht në terren të rrafshët pranë ujit, por nuk mungojnë dhe ato në rrafshnalta e shpella. Arkitektura karakterizohet nga strukturat e mbidheshme dhe më pak nga ato të nëndheshme, si dhe me forma absidore. Strukturat, bashkë me çatinë, janë nga druri dhe kashta e lidhur dhe të përzier me llaç. Materialin e lëvizshëm e karakterizojnë mikrolitet nga guri i gdhendur. Me teknikë të guri të latuar gjenden tophat, rruazat, sëpata në formë gjuhe e këpuce etj., nga ashti janë shpueset, gjilpërat etj.; ndërsa nga bakri sëpatat e holla, thikat etj. Poçaria është më e varfër se e kulturës Baden, me forma më të cekëta ovale e më bikonike (tipi Fischbutte), me vegjet më të zhvilluara se ato të Badenit me vegje të vogla, pjesë të lartë cilindrike dhe fund të rrumbullaksuar. Zbuku-

rimet në qeramikë janë bërë me incezime e perkusion, gati si në Baden, pos që në Kostolc ka dhe ngjyrim me inkrustim të bardhë (tipi Furchenstih) dhe në motive mungojnë ato të tavolinës së shahut dhe flegrat apo gjysmëhënat. Kultura njeh dhe figurina antropomorfe romboide, pa kokë ose me kokë shumë të vogël e të dekoruara me incezime. Shtresë e kësaj kulture është zbuluar dhe në lokalitetin Hisar të Suharekës. (Kushtrim Kuçi)

KULTURA BUBANJ-HUM. Kompleks i gjerë kulturor i epokës së eneolitit të hershëm (kapërcyelli i mijëvjeçarit IV-III p.e.r.). Me kulturën Salkuca përfshiheshin hapësira nga Deti i Zi në lindje, lumi Drina dhe Kosova në perëndim, Greqi Veriore në jug dhe malet Karpate në veri. Karakteristikë e saj është përdorimi i bakrit për armë, vegla pune e stoli, ngritja e vendbanimeve mbi kodra me mbrojtje të mirë natyrore apo në lugina ndërmallore, zbukurimi i enëve të qeramikës me grafit, tipi i enës “kantaros” dhe hyjneshat në trajtë pete të lakuar. Lokalitetet e njohura të kësaj kulture në Kosovë janë Gadimja e Epërme (Lipjan), Hisari i Suharekës, Gërmia e Prishtinës etj. (Haxhi Mehmetaj)

KULTURA DANILO. Kulturë e epokës së eneolitit të mesëm të Grupit Adriatik (4500-3900 p.e.r.). Emrin e mori nga lokaliteti Danillo te Shibeniku (Kroaci) dhe shtrihej përgjatë bregdetit Adriatik, nga lumi Po te Triesta në veri (Itali) e deri te lumi Devoll e liqeni i Ohrit në jug. Ekonomia u zhvillua varësisht nga relievi, në ultësira peshkataria e bujqësia (Danillo, Smilçiq), e në vende malore gjuetia e blegtoria (Cërvena Stijena). Vendbanimet gjendeshin në hapësira të hapura e shpella dhe kishin shtëpi të nëndheshme, gjysmë të nëndheshme e mbi dhe, me planimetri rrethore, ovale e katrore të parregullta. Muret janë bërë nga degë të lyera me llaç, me çati nga kashta ose sana, ndonjëherë të përziera me llaç. Për qëllime të mbrojtjes janë bërë dhe istikame ose gjerdhe (palisadat). Nga guri i gdhendur janë bërë thikat, preset, shpueset, majat, daltat e tophat; nga guri i latuar sëpatat, daltat, çekanët, qaforet, tophat etj.; ndërsa nga ashti janë bërë shpueset, gjilpërat, grepat, qaforet, rruazat, fyejt etj. Kultura u zhvillua në tri faza dhe enët kanë trajta sferike, gjysmësferike, bikonike dhe ovale, me qafë konike, në trajtë

të shkronjës S dhe cilindrike dhe me fund të sheshtë unazor apo konik. Karakteristikë e kulturës është qeramika e zbukuruar me teknikë imreso-kardium, si dhe me spirale e trekëndësha të shrafuar, si dhe ritonet, që ishin objekte të veçanta kulti, por njihet dhe pikturimi i bërë me ngjyrë të zezë, të bardhë e të kuqe. Skulptura është bërë nga argjila dhe ka formë konike njeriu apo reale njeriu, por janë të pranishme dhe figurat e kafshëve me zbukurime në qeramikë. Sipas A. Benac, ndikimi i grupit arriti në vise ku depërtonte klima mesdhetare dhe në prapatokë të saj, siç arriti përmes Drinit të Bardhë në Dukagjinin Jugor (Reshtani i Suharekës: bashkëjetoit me kulturën vinçiane). Përmes Drinit të Zi depërtoi edhe në Pellagoni (Uste në Drin, Maqedoni), ndërsa përmes Devollit në Cakran (Shqipëri). (Kushtrim Kuçi)

KULTURA E BËRNICËS. Kulturë dardane e kapërcyellit nga epoka e bronzit në të hekurit (shek. XII-IX p.e.r.). Mori emrin sipas nekropolit të Bërnices së Poshtme, 5 km në veri të Prishtinës. Shtrihej në Kosovë, Sanxhak, Serbinë Jugore dhe Maqedoninë Veriperëndimore. Përfaqësohet nga vendvarrime dhe vendbanime. Nekropolet më të njohura janë: i Grashticës, i Keqekollës e Ulpianës te Prishtina, i Kluçkës-Hipodromi i Shkupit, i Donja Topionicës e Gornja Strazhavës te Prokupla dhe Glogoviku te Dojeviqi i Peshterit. Vendbanimet janë konstatuar në Bardh të Madh e Graboc të Ulët të Fushë-Kosovës, Keqekollë, Ticë të Skënderajt dhe Gornja Strazhavë. Tiparet e kulturës së Bërnices janë varrimi me djegie dhe vendosja e mbetjeve mortore në enë të qeramikës (urna). Varret janë individuale apo të vendosura në grupe dhe shënjohe e mbrohen më rrasa të papunuara gurësh, rrasa të gdhendura gurësh dhe konstruksione toloide nga gurët e bardhë lumor. Ndeshen varre me trupvënie, si vazhdim i traditave pararendëse të epokës së bronzit. Qeramika përbehet nga urna, pjata, tasa, filxhanë, enë dyshe etj. Prijnë urnat dykonike më qafë cilindrike, buzë të gjera, të pajisura me nga dy apo katër vegje; pjatat e thella cilindrike pa vegje apo me nga dy e katër vegje të larta mbi buzë, me maja të zbukuruara me një shtesë në formë pulle. Gjenden dhe enë me motive gjeometrike, stil tipik vetëm i kësaj kulture. Si stoli veçohen gilpërat zbukuruese nga bronzi e ashti, rruazat nga qe-

libari e bronzi, pullat dhe tëmthorët nga pafta bronzi. (Haxhi Mehmetaj)

KULTURA E GLLASINACIT. Kompleks kulturor ilir i epokës së bronzit dhe i epokës së hekurit. Kultura shtrihej me variantet e saj në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Shqipërinë Veriore, Kosovë, Serbi dhe Maqedoninë Veriperëndimore. Kultura mori emrin sipas rrafshnaltës Gllasinac, e cila gjendet në lindje të Sarajevës. Në këtë rrafshnaltë dhe rreth saj janë gjetur disa mija tuma dhe shumë vendbanime të fortifikuara kodrinore. Hulumtimet e para në të kanë nisur nga austro-hungarezët dhe vazhduan deri në fund të shek. XX, nën udhëheqjen e Muzeut të Sarajevës. Objekti më i njohur i hulumtimeve të para është "Karroca e Gllasinacit", karrocë kulti prej bronzi, e tërhequr nga dy shpezë (Muzeu i Vjenës). Sipas arkeologëve A. Benac dhe B. Çoviq, të cilët e bënë kronologjinë e kulturës së Gllasinacit, kjo kulturë u zhvillua në vazhdimësi gjatë disa fazave: Gllasinac I: epoka e hershme e bronzit/periudha parailire (1800-1500 p.e.r.); Gllasinac II: epoka e mesme e bronzit/periudha protoilire (1450-1300 p.e.r.); Gllasinac III: epoka e vonë e bronzit/periudha e hershme ilire (1300-800 p.e.r.); Gllasinac IV: periudha hallshtatiane (800-500 p.e.r.); Gllasinac V: periudha latene (500-200 p.e.r.).

Gjatë epokës së bronzit kanë ekzistuar bashkësi më të vogla njerëzore, ndërsa vetëm nga epoka e hekurit, në veçanti nga shek. VIII, ka nisur një zhvillim më intensiv kulturor. Kapërcyelli i shek. VII-VI p.e.r. është shënuar dhe me dukjen e varreve tumulare të parisë fisnore, me objekte të pasura: armë, pajisje ushtarake, stoli, enë bronzi, qeramikë, pajisje kuajsh etj. (tuma në Ilijak, Ararevë, Poblacenicë, Pilatoviq, Krivarekë, Razhanë, Vranë, Gotovushë etj.). Gjetjet e objekteve të shumta prej ari e argjendi edhe në tumat në Banjë të Pejës, Novi Pazar apo Atenicë janë dëshmi të prezencës së punëtorive lokale të arit e argjendit (stolitë e tipit mramorc). Në shumë tuma janë gjetur dhe përkrenare ilire, që më parë janë quajtur greko-ilire dhe shumë më parë si greke/korintike, për të cilat mendohet po ashtu se janë punuar në vend. Në tumat luksoze janë gjetur dhe imorte të enëve me figura të zeza, që dëshmojnë kontaktet me Jugun e zhvilluar. Si pjesë e kompleksit të Gllasinacit u zhvillua dhe varianti Gllasinac-Mat, ku bëjnë pjesë

lokalitetet e Shqipërisë Veriore dhe të Kosovës. (Edi Shukriu)

KULTURA E KOMANIT. Kulturë e mesjetës së hershme abërore. Komani (Dalmace), i njohur që prej shek. XIX për nekropolin e pasur, është kthyer në eponimin e një qytetërimi të hershëm mesjetar shqiptar. Pas gërmimeve të para të varreve nga Aleksandër Degrand (1898), kërkimet sistematike të kryera nga S. Anamali dhe H. Spahiu në varrezën pranë Kalasë së Dalmaçes (1961-1982-1983) dhe në vende të tjera provuan se Kultura e Komani i takon mesjetës së hershme dhe se bartës të saj ishin banorët autoktonë, arbit. Gërmimet arkeologjike të viteve 2008 e më tej zbuluan se vendbanimi i Komani njohu në fillim të periudhës mesjetare disa transformime të mëdha, që i dhanë dhe pamjen e një qendre urbane, me zona të banuara dhe zona prodhimi, me nekropol të shtrirë, si dhe të fragmentuar rreth kishave të shumta të shpërndara në nivele të ndryshme të vendbanimit. Shtimi i monumenteve të kultit bëhet tipar dallues në topografinë e Komani gjatë shek. VIII-XII, si ndodhi dhe në lokalitetet e tjera të mesjetës së hershme në Shqipërinë Veriperëndimore (Sarda, Danja, Lezha). Nekropoli është përdorur pa ndërprerje nga periudha romake e vonë (shek. IV-V) deri së paku në shek. XIII, duke dhënë mundësi të ndjekjes së historisë së popullsisë lokale për një periudhë gati mijëvjeçare. Ky zhvillim vazhdoi deri në shek. XIII, megjithëse disa gjetje të rralla arkeologjike dëshmojnë për okupimin e lokalitetit deri në shek. XV. Kultura e Komani është zbuluar edhe në Banjë të Malishevës, në Matiçan, Graboc etj. (Kosovë), në Mjelë (Mal i Zi), rreth liqenit të Ohrit (Maqedoni) dhe në Afionë të Korfuzit (Greqi). Tërësia e tipareve të kësaj kulture shërben si dëshmi se bartësit e saj janë arbit e mesjetës së hershme dhe se shtrirja e saj përputhet përgjithësisht me trevën e Arbanonit mesjetar. (Luan Perzhita)

KULTURA E STARÇEVËS. Kulturë e neolitit të hershëm dhe të mesëm (5500-4000 p.e.r). Emrin e mori sipas fshatit Starçevë pranë lumit Danub, 9 km në lindje të Paçevës (Serbi, 1912). Gërmimet e para i bëri Muzeu Kombëtar i Jugosllavisë dhe Universiteti i Harvardit (1928-1939). Kultura e Starçevës bën pjesë në grupin e Ballkanit Qendror, bashkë me kulturat Keres e Krish dhe shtrihet

në Serbinë e sotme, në Kosovë, Vojvodinë, pjesërisht në Bosnjë, në Kroaci, Hungari, Rumani, Bullgari, Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi. Kufi verior ka Danubin, në lindje Karpitet e lumin Morava, në juglindje lumin Vardar, në jug Malet e Sharrit, në perëndim lokalitetin Obre dhe lumin Drina dhe në veriperëndim lokalitetin Zhdralovi në Kroaci. Pos blegtorisë, gjuetisë e peshkimit, kishte për bazë format e para të bujqësisë. Vendbanimet gjenden në ultësira, pranë lumenjve, me shtëpi të nëndheshme e gjysmë të nëndheshme dhe në fazat e vona mbi dhe. Në dy fazat e fundit shtëpitë janë prej druri/degëve, ndërsa kulmi duket se ishte i mbuluar me kashtë e sanë, që të gjitha të mbuluara me baltë. Planimetritë ishin rrethore, ovale dhe katrore jo të rregullta. Veglat dhe armët janë nga guri, ashti e druri dhe me teknike gdhendjeje janë vetëm mikrolitet nga stralli e obsidiani dhe veglat që shërbenin si shat, kazmë, daltë, drapër (me ose pa dhëmbëzorë). Me teknikën e re të latimit janë bërë sëpatat (në formë këpuce, gjuhe etj.), moknat, rruazat, pullat, grepat, etj. Prej ashti janë gjilpërat, shpueset, amuletet e shpuara ose të lakuara (edhe nga brirë dreri në formë "T"). Brirët e drerit janë përdorur si kruese e lopata. Qeramika ka trajtë sferike ose gjysmësferike, që fiton trajta bikonike më pas. Në këtë kulturë janë evidentuar tri faza kryesore të zhvillimit: Faza I karakterizohet me qeramikë të fakturës së trashë, me funde të rrafshëta, unazore, cilindrike masive apo konike të sheshta, me dekorim të teknikës barbotin, por dhe me prezencën e asaj plastike, inezim, impreso, me motive vijash zigzage, paralele, rrjete e trekëndësha të vendosur horizontalisht apo vertikalisht. Faza II a karakterizohet me fund të shpeshtuar cilindrik, me dominim të fakturës së trashë dhe rritjen e qeramikës me parete të holla, me zburim gati të njëjtë, si në Fazën I; Faza II b ka paraqitje relativisht të barabartë të qeramikës, me parete të trasha e të holla, por mungon pikturimi me ngjyrë të çelët në sfond të errët dhe spiralja; Faza III ka dhe enë me trajtë bikonike, me dekorim paksa të pasuruar, dominim të barbotinit dhe kthim të pikturimit me ngjyrë të çelur në sfond të errët dhe të spirales. Për herë të parë paraqitet spiralja që përfundon në kthetër/dorë dhe polikromia, e cila, përmes vijës së bardhë, nënvizon spiralen e pikturuar me të zeze në sfond të çelur.

Kultura karakterizohet me figura femërore kulti nga argjila e papjekur dhe e pjekur. Zhvillimi i tyre përcillet në fazat vijuese: Faza I ka trajta cilindrike, sy e flokë të incezuar dhe hundë e gjinj të modeluar; Faza II ka figura në formë konike ose bikonike dhe vjen në pah ndarja e trupit nga koka, përmes trajtësimit të qafës dhe modelimi i zbatuar edhe në flokë dhe sy, në vend të incezuar; Faza III karakterizohet dhe me lirim të duarve nga trupi. Në Kosovë të veçanta janë figurinat nga Glladnica, Vlashnja, Varoshi etj. Ka dhe altarë kulti me 3 apo 4 këmbë të zbukuruar me vija zigzage, ndonjëherë të ngjyrosura me të zeze apo të kuqe. Vendbanimet më të rëndësishme të kulturës së Starçevës në Kosovë janë Runiku te Skënderaj, Zhitkoci te Mitrovica, Vlashnja e Gjonaj-Tupec te Prizreni etj. (Kushtrim Kuçi)

KULTURA E VINÇËS. Kulturë e epokës së neolitit të vonë dhe e eneolitit të hershëm. Emrin e mori sipas vendzbulimit të parë në fshatin Vinçë afër Beogradit (Serbi). Është zëvendësuese e kulturës së mëhershme të Starçevës dhe ka shtrirje gjeografike nga baseni i Sofjes në lindje, deri te lumenjtë Bosnja e Usorja në perëndim, lugina e Shkupit në jug dhe Potisja e mesme në veri. Ndahet në dy faza: Vinça Tordosh (A-B: neoliti i vonë) dhe Vinça Ploçnik (C-D: eneoliti i hershëm). Në Kosovë dhe në trevat fqinje u zhvillua varianti i veçantë, i cili manifestohet sidomos në trajtimin e figurave antropomorfe (shih: Hyjnesha në Fron). Vendbanimet e fazës së parë janë kryesisht disashtresore dhe ngriheshin në rrafsh dhe pranë lumenjve, kurse në fazën e dytë disa vendbanime të variantit Kosovë-Moravë Jugore u vendosën në kodra, me mbrojtje të mirë natyrore. Vendbanimet më të rëndësishme të kulturës së Vinçës në Kosovë janë Tjerrtorja e Bardhoshi te Prishtina, Fafosi e Vallaçi te Mitrovica, Runiku te Skënderaj etj. (Haxhi Mehmetaj)

KULTURA ORIENTALE NË KOSOVË. Që në dekadat e para të pushtimeve osmane dhe të vendosjes së pushtetit të Perandorisë Osmane në Kosovë, si kudo tjetër, sipas sistemit të vakëfeve, u themeluan institucione islame të karakterit fetararsimor, social e humanitar, ekonomik dhe tregtar. Këto institucione sollën ndryshime të mëdha në mënyrën e jetës, në urbanizëm dhe arkitekturë, në zejtar, artizanale dhe në kulturën popullore, përfshirë banimin,



NJË OBJEKT I KULTURËS ORIENTALE NË KOSOVË

ushqimin dhe veshmbathjen. Vendbanimet dhe jeta urbane në Kosovë që në shekullin e parë të periudhës osmane kanë njohur dimensione të reja zhvillimi. Qytetet si Prizreni, Peja, Vuçitërna e Prishtina, sikurse edhe vendbanimet pranë minierave si Novobërda, Trepça etj., në fund të shek. XVI morën fizionomi orientale, me xhamitë, medresetë, teqetë, hamamet, hanet, çarshitë, dyqanet e zanateve të ndryshme, shatërvanët e çezmet etj. Që në atë periudhë, në qytetet e Kosovës u formuan mëhallët myslimane me të gjitha elementet e urbanizmit oriental. Nga vitet tridhjetë të shek. XVI në Kosovë filluan të ndërtohen edhe kasaba të reja. Vakëfnametë, epigrafia dhe dokumentet e periudhës osmane vënë në dukje se shumica dërrmuese e institucioneve të ndryshme islame u ndërtuan në Kosovë nga shtresa drejtuese vendëse. Bërthamën e kësaj shtrese e përbënte fisnikëria feudale shqiptare e periudhës paraosmane, siç ishin: Dukagjinët, Mahmudbegollët, por edhe ajo e mëvonshme, si Rrotllajt e Prizrenit, Kryezinjët e Gjakovës, Gjinoollët e Gjilanit dhe të Prishtinës etj. Nga kjo shtresë dolën figura të shquara, të cilët zunë pozita të rëndësishme drejtuese në Kosovë dhe në Perandorinë Osmane. Edhe njerëz të pasur nga radhët e popullsisë vendëse kontribuan në ngritjen dhe vakëfimin e objekteve fetare dhe kulturore islame, përfshirë edhe bibliotekat, xhamitë etj. Edhe femra të pasura shqiptare të besimit islam kanë vakëfuar objekte fetare, kulturore dhe dorëshkrime islame në Kosovë. Janë dalluar Gylfem Hatuna në Pejë, motrat Sofa dhe Hanka në Gjakovë (shek. XVIII), ndërkaq në Prishtinë dy gra ndërtuan nga një xhami, të cilat njihen me emrat xhamia Hatunije,

ndërtuar në shek. XVI dhe xhamia Kadrije, ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XIX. Shehzade Hanmi, e bija e Mehmet Tahir Pashë Rrotllës nga Prizreni ndërtoi një xhami në Gjilan në vitin 1835 etj.

Duke filluar nga shek. XV, nga Kosova kanë dalë me dhjetëra shkrimtarë e poetë, që kanë krijuar në të tri gjuhët orientale: osmanisht, arabisht dhe persisht. Disa prej tyre arritën të ngjiten në nivelin e elitës letrare dhe kulturore osmane. Nga shek. XVIII në Kosovë, krahas letërsisë së divanit filloi të lëvrohet edhe letërsia shqipe me alfabet arab, e njohur si letërsi shqipe alhamiada. Trashëgimia kulturore orientale e Kosovës, që ka arritur deri në ditët tona, është pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore e banorëve të këtij vendi. (Nehat Krasniqi)

KULLA E DUKAGJINIT (shek. XVIII-1912). Banesë e fortifikuar shqiptare, e ndërtuar në shek. XVIII dhe XIX, e përhapur në shumë fshatra dhe në disa qytete të Kosovës. Kulla është vlerë e veçantë e kulturës materiale, që i takon një periudhe të caktuar kohore dhe historike. Ajo shpreh gjendjen ekonomike, klasore dhe sociale, si dhe mënyrën e jetesës së banorëve në disa zona të Rrafshit të Dukagjinit. Ka luajtur rol me rëndësi në jetën e banorëve të kësaj zone, duke kryer funksionim e banimit, të strehimit dhe të mbrojtjes. Si pjesë e një thesari popullor me vlerë të jashtëzakonshme, kulla zë një ndër vendet kryesore në arkitekturën shqiptare si për nga numri, po ashtu edhe nga territori në të cilën shtrihet. Kullat janë ndërtuar nga mjeshtër shqiptarë të “shkollës së Dibrës”, të cilët patën një eksperiencë të gjatë në këtë lloj ndërtimi arkitekturor. Kulla mund të paraqitet si kompleks, apo edhe e veçuar. Në veprimtarinë arkitekturore shqiptare ato paraqesin një shkollë më vete, si tip ndërtimi me veçori specifike, të lidhur ngushtë me karakterin etnik dhe kulturor të disa territoreve shqiptare. Arkitektura e kullës dukagjinase, përfshirë edhe format e tjera figurative dhe të zbatuara, kanë një gjuhë specifike dhe origjinale. Ndërtimet e këtylla me kohë u bënë mbizotëruese në Dukagjin dhe u përhapën jo vetëm të feudalët dhe të pasurit, por të gjitha shtresat e popullsisë, sidomos në fshatra. Kullat si ndërtim u përhapën veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XIX. Si tip ndërtimi, ajo është unike, por në vete përmban katër variante

dhe gjashtëmbëdhjetë nënvariate. Tipi më vjetër i ndërtimit është kulla me dyshekllek të drurit, që del nga muri ose muret parametrale në formë ancaku dhe që u realizuan në shek. XVIII. Ndërsa më të reja janë ato me dyshekllek të gurit, që dalin apo nuk dalin nga muri apo muret perimetrale të kullës. Kullat kanë bazë katërkëndëshe kënddrejtë dhe janë dy, tri dhe katërkatëshe. Çdo kat ka funksion të caktuar: në përdhës është ahuri, sipër tij janë qilarët me shtëpinë e zjarrit dhe një kat më lart oda e burrave apo e mysafirëve. Kjo odë është edhe më e madhja dhe më e bukura. Dera dhe dritaret kryesisht janë të mbuluara me hark dhe të ndërtuara nga gurët e përpunuar. Me këtë teknikë janë punuar edhe skajet e mureve të kullës. Kulla ka çati katërujësë dhe është e mbuluar me qeramidhe tradicionale. Mbi çati janë oxhaqet si dhe baxha, që me vertikalet e tyre e thyejnë monotoninë e kulmit. Disa kulla në Kosovë edhe sot e kanë ruajtur origjinalitetin e tyre, përfshirë edhe mjedisin ku janë ndërtuar. (Fejaz Drançolli)

KULLA E HASAN AGËS (1580). Është e vetmja kullë në fshatin Rogovë të Hasit. Kulla e Hasan Agës, apo e Ymer Pogë Latifit, siç njihet sot nga banorët e zonës, është ruajtur në gjendjen e saj fillestare. Kulla nuk ka oxhak as dalje të tymit, që bën me dije se kulla është verore. Në këtë drejtim ajo është e veçantë dhe e vetmja që ka mbetur deri në ditët e sotme. Kulla ka planimetri të katërkëndëshit kënddrejtë, është dykatëshe dhe paraqet objektin më të vjetër të banimit të tipit kullë. Ka çati katërujësë nga jashtë, ndërsa nga brendësia është me kube. Si material për ndërtimin e kullës është përdorur guri, tjegulla dhe druri. Gurët janë natyrorë, të përpunuar dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Kurora e kulmit është nga guri i latuar, i profilizuar dhe del në formë ancaku. Çatia është e mbuluar me rrasa guri, muret janë mjaft masive dhe në bazë kanë një gjerësi prej 100 cm. Kjo gjerësi, duke u ngritur në kate, nga brenda, zvogëlohet në mënyrë të shkallëshkallshme, kështu që në katin më të lartë gjerësia arrin 75 cm. Dera e hyrjes nga brenda sigurohet me shul. Në pjesën e nënshkallëve është një pus, i cili tani është i mbyllur. Kulla ndriçohet dhe ajroset nga dritaret me hark, si dhe me frëngji. Në katin më të lartë është edhe nyja sanitare, që del nga muri perimetral në formë konzole, me dy rende guri. Kulla ka çati katërujësë, është e

mbuluar me qeramidhe tradicionale dhe nuk ka baxhë e as oxhaqe. Objekti ruan gjendjen fillestare, por është i vetëm në mjedisin ku është ndërtuar. (Fejaz Drançolli)

KULLA E ISA BOLETINIT (shek. XIX). Pjesë e kompleksit të fortifikuar të Isa Boletinit, që paraqet një tërësi unike në arkitekturën e Shalës së Bajgorës dhe më gjerë. Shtëpia-fortesë,



KULLA E ISA BOLETINIT NË SHALË TË BAJGORËS

rrënojat e kullës, muret e avllisë me portën e hyrjes (të restauruara) janë pjesë e kompleksit dhe i përkasin arkitekturës fshatare të shek. XIX. Kompleksi i fortifikuar me kullë nga viti 1830 e deri në vitin 1912 u shkatërrua gjashtë herë. Shkatërrimet e fillimit të shek. XX u bënë nga xhonturqit. Rrethanat politike, shoqërore-ekonomike dhe sociale, duke mos lënë anash as faktorët e natyrës ndikuan në ndërtimin dhe rindërtimin e këtij kompleksi të fortifikuar familjar me lloje të ndryshme ndërtimesh për banim ose për mbrojtje. Kulla, apo “Oda e Isa Boletinit”, zë vend në pjesën verilindore të kompleksit të fortifikuar. Sot ajo është rrënojë, por e konservuar. Nga objekti i mbetur vërehen trajtat e mureve të përdhësës, deri në një metër lartësi, jo në të gjitha anët e objektit. Nga muret ekzistuese mund të shihet se kulla ka planimetri me bazë katrore dhe si material ndërtimor është përdorur guri i latuar. Gurët janë masivë, blloqe të formave kuadratike. Në katin përdhës ka edhe frëngji pushke me formë të shkronjës “V”. Kulla ishte dykatëshe dhe, pos ahurit për kuaj, kishte edhe odën e mysafirëve në katin e sipërm. Komunikimi mes kateve bëhej me ndihmën e shkallëve të drurit, që ishin pjesë e enterierit të kullës. Karakteristikë për kullën është shtylla mbajtëse, e cila ishte e vendosur në mes të ahurit dhe ishte e ndërtuar

e tëra prej guri. Kulla ka pasur çati katërujësë, të mbuluar me qeramidhe tradicionale. Kulla e Isa Boletinit, pos rëndësisë historike, ka edhe vlera arkitektonike. (Fejaz Drançolli)

KULLA E ZENEL BEUT (shek. XIX). Godina i takon kullës së vjetër qytetare dhe gjendet në kuadër të kompleksit të njohur “Konaku i Zenel Beut.” Donator i kompleksit ishte



KULLA E ZENEL BEUT NË PEJË

Zenel Begolli. Kulla të këtilla, në kuadër të komplekseve arkitekturale, ka pasur në numër të konsiderueshëm në qytetin e Pejës. Kulla, si pjesë e kompleksit, gjendet në rrugën apo mëhallën e Pelivan Mejdanit. Ajo ka planimetri katërkëndëshe kënddrejtë dhe çati po të njëjtës formë, e cila mbaron në formë piramidale. Mbi çati janë oxhaqet dhe baxha, që si elemente konstruktive dhe funksionale ndikojnë në thyerjen e monotonisë së kulmit. Çatia ishte e mbuluar me qeramidhe tradicionale. Kulla ishte trikatëshe dhe çdo kat kishte pasur funksion të caktuar. Në katin përdhës kanë qenë magazinat, një kat më sipër kthinat e fjetjes, ndërsa në katin më të lartë oda e mysafirëve. Komunikimi me ambientet e kateve bëhet me ndihmën e shkallareve të brendshme prej druri, që ngjiteshin nga kati përdhës deri në katin më të lartë. Pos shkallëve të brendshme, që shfrytëzoheshin nga mysafirët, kulla kishte edhe shkallët e jashtme. Shkallët e jashtme ishin prej guri dhe shfrytëzoheshin vetëm nga familjarët.

Kulla e Zenel Beut është objekti më i vjetër e këtij tipi të ndërtimit në qytetin e Pejës. Ndërtimi, pos tjerash, veçohej edhe me dekorime të arteve aplikative në kthinat e veçanta. Oda e mysafirëve ishte pjesa më e bukur e kullës. Ajo kishte tavanin me rozetë në qendrën e saj,

dollapët, musandra, raftet e dekoruara dhe derën e odës. Çdo odë kishte hamamxhikun. Kulla, pos vlerës arkitektonike, ka edhe vlera artistike, historike, etnologjike etj. Kulla e Zenel Begut u dogj në luftën e fundit shqiptare në muajin prill të vitit 1999. Me restaurim pamja e jashtme e kullës u kthye pothuajse në gjendjen fillestare. (Orges Drançolli)

KULLASHI Muhamedin (1949-). Filozof, profesor universiteti, anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK). Lindi në Pejë, ku mbaroi shkollimin



MUHAMEDIN
KULLASHI

fillor dhe të mesëm. Kreu studimet për filozofi dhe gjuhë frënge në Universitetin e Zagrebit, ku magjistroi dhe doktoroi (1983). Punoi si asistent dhe ligjërues në katedrën filozofi-sociologji të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës nga viti 1974 deri më 1991. Ushtrroi detyrën e kryeredaktorit të revistës "Thema" në periudhën 1984-1988. Në vitin 1992 u zhvendos në Francë dhe atje u zgjodh profesor i filozofisë në Universitetin Parisi VIII. Ka përkthyer në gjuhën shqipe disa tituj të autorëve, siç janë: Didëro, Sartër, Lëfevër, Liotar, Lefort, Fanon, Garodi etj. Është autor i një sërë veprash nga fusha e filozofisë dhe e mendimit sociopolitik, si: "Filozofema" (1979), "Kah metafizofia" (1986), "Vetëpërkufizimi i njeriut" (1987), "Ese filozofiko-politike" (1994), "Përplasja e identiteteve" (2003) "Mendimi politik modern" (2005) "Pushteti dhe dija te Michel Foucault" (2008), "Politika, lufta dhe diplomacia" (2012), "Dy gjenealogji të modernitetit" (2016) etj. Në gjuhën kroate botoi librin "Drejt metafizofisë" (Ka metafizofiji, Zagreb 1986). Është autor i disa librave të botuar në gjuhë frënge: "Humanizmi dhe urrejtja" (1997) (dhe në gjuhën spanjolle, 2004). Botoi artikuj në gazetën "Le Monde", "Libération", "La Croix" etj. Është bashkautor i disa librave të botuara kryesisht në Paris dhe Bruksel, që u kushtohen luftërave në ish-Jugosllavi dhe Kosovës, pastaj artikujve të botuar në revistat dhe gazetën e njohura franceze, pjesëmarrës në shumë konferenca e simpoziume shkencore dhe në debate të shumta të organizuara për çështjen e Kosovës. Në vitin 1992, së bashku me emra të

njohur intelektualë francezë, themeloi në Paris Komitetin "Kosova", i cili bashkë me revistën e njohur "Esprit", ndikuan në formimin e opinionit francez për çështjen e Kosovës. Bashkëpunon me departamentin e sociologjisë dhe të filozofisë të Fakultetit Filozofik të UP-së, duke mbajtur ligjërata në cilësinë e profesorit vizitor. Që nga viti 2008 është anëtar i jashtëm, ndërsa nga viti 2016 anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Ishte ambasadori parë i Republikës së Kosovës në Paris. (Shemsi Krasniqi)

KULLAT E FSHATIT (shek. XVIII-XIX). Ndërtime popullore të fortifikuara, si shtëpi familjare të ngritura në fshatra të ndryshme të Kosovës, në fund të shek. XVIII e gjatë shek. XIX. Pos Rrafshit të Dukagjinit, kulla u ndërtuan edhe në fshatrat e rajonit të Drenicës, si dhe në disa lokalitete të rajonit të Kosovës. Në të vërtetë, në disa nga këto rajone çdo objekt i banimit me dy kate dhe me mure prej guri nga banorët vendës njihet si kullë. Këto ndërtime tipologjikisht nuk i takonin kullës klasike. Numri i kullave si banesa familjare në rajonin e Drenicës ishte i madh, por tash kanë mbetur fare pak. Shumica janë rrënuar ose nga koha, por edhe nga bombardimet e artillerisë turke ose serbe. Të gjitha këto ndërtime kanë katin përdhes dhe katin e sipërm. Kullat e Drenicës janë ndërtuar kryesisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe kanë dyshekllekun që del nga muri perimetral. Në katin përdhes është ahuri, ndërsa në katin e parë oda e burrave me elementet karakteristike të odave shqiptare, nga e cila shkohet nëpër divanhane. Çatia katërujësë ishte e mbuluar me qeramidhe tradicionale, por edhe me rrasa guri. Në rajonin e Drenicës këto ndërtime ishin mbizotëruese, por kishte edhe tipa të tjera të arkitekturës fshatare. (Fejaz Drançolli)

KULLAT E JUNIKUT (shek. XVIII-XIX). Janë shtëpi banimi, të ngritura në afërsi të njëra-tjetrës, që formojnë komplekse rurale. Komplekset e këtyllë, të ndërtuar në shek. XVIII e XIX, ishin karakteristike për disa fshatra të Rrafshit të Dukagjinit, të Junikut në veçanti. Kullat e Junikut u ngritën kryesisht në terren të rrafshët dhe u formuan sipas mëhallëve dhe familjeve të caktuara, si: Tregovishtë, Gacaferr, Berishë, Çok, Gaxher, Miroc, Çestë, Goç, Bajraktar e Pepsh. Kullat më të vjetra, ato të variantit me dyshekllek druri që dalin nga muri,



KULLAT E JUNIKUT

janë të përqendruara në mëhallët qendrore, si: Tregovisht, Gacaferr e Berishë. Këto kulla trikatëshe u ndërtuan në shek. XVIII, por ka edhe kulla më të reja, që i takojnë variantit të kullave me dyshekllek të gurit, që dalin ose jo nga muri perimetral i kullës. Daljet e këtilla të galerive në katin më të lartë i takojmë te secila kullë. Kullat ndonjëherë janë dykatëshe, por më shpesh trikatëshe. Çdo kat ka funksion të caktuar: në përdhës është ahuri, në katin sipër qilarët dhe shtëpia e zjarrit, ndërsa në katin e lartë oda e burrave. Kjo odë është më e madhja, por edhe më e bukura. Oxhaku, tavanet, raftet, dollapët, trapazani etj. veçohen me drugdhendje mjeshtërore. Për ndërtimin e kullave është përdorur guri i lidhur me llaç gëlqereje. Dyert ishin të mbuluara kryesisht me hark. Kullat kishin çati katërujësë të mbuluara me qeramidhe tradicionale. Oborret ishin të rrethuara me mure prej guri. Në Junik ishte e njohur edhe “Oda e Junikut”. (Fejaz Drançolli)

KULLAT E QYTETIT (shek. XIX). Ndërtime popullore shqiptare të fortifikuara, si shtëpi familjare të ngritura në disa qytete të Kosovës. Pos në fshatra, ndërtime të tipit kullë u ngritën edhe në disa qytete të Kosovës, veçmas në Gjakovë dhe në Pejë. Janë të ndërtuara me gurë të latuar të lidhur me llaç, një ose dykatëshe. Guri i përpunuar është përdorur veçmas në dyer të oborrit, në derën e kullës, në dritare, nëpër qoshe apo edhe në tërësi të ndonjë muri të kullës. Kulla si banesë e fortifikuar familjare në qytet është ruajtur shumë rrallë deri në ditët tona. Ato u ndërtuan nga bejlerët, agallarët përgjithësisht njerëzit e kamur të qyteteve. Nga këto kulla të mbetura duhen përmendur kullat njëkatëshe të Kasapollëve, të Kyqkalive, të Broçëve, të Kurtulëve dhe të Spahive, ndërsa

nga dykatëshet kullën e Zenel Beut, të Goskajve, kullën e Haxhi Zekës a Jashar Pashës, kullën e Sheremetit në Pejë, të familjes Koshi në Gjakovë etj. Në këto kulla vërehet një gërshetim i elementeve të arkitekturës së vjetër qytetare dhe kjo vërehet në enterier, përkatësisht në odën e mysafirëve dhe në dhomat e tjera, në elementet funksionale dhe dekorative në veçanti.

Kulla qytetare për nga koha e ndërtimit është më e re se kulla fshatare. Objektet përmbajnë tiparet e kullave fshatare, me përjashtim të disa elementeve të brendësirës, përkatësisht të odës së mysafirëve dhe të kthinave të tjera. Pozita shoqërore, kushtet ekonomike dhe pozita klasore ndikuan në zgjedhjen e mjeshtërive më të njohur dhe më me përvojë, gjë që ndikoi edhe në cilësinë e ndërtimit dhe të dekorimeve. Përveç kësaj, kulla ka pasur edhe evoluim të vazhdueshëm, ku shihet një përpunim i vazhdueshëm i elementeve arkitekturore, si dhe një përsosje e vazhdueshme teknike dhe artistike, duke mos lënë mënjane shijen dhe ndjenjën estetike. Kullat qytetare, pos tjerash, veçohen edhe me dekorimet aplikative, si dhe figurative në raste. Me dekorime janë stolitur oda e mysafirëve me oxhakun, tavanet, raftet dhe dyert e tyre. Kullat kanë planimetri katërkëndëshe kënddrejtë dhe çati katërujësë, të mbuluara me qeramidhe tradicionale, monotoninë e së cilës e thyejnë oxhaqet dhe baxha. Format fillestare të këtyre ndërtimeve tashmë nuk ekzistojnë, sepse janë shkatërruar dhe rindërtuar në kohë dhe rrethana të ndryshme. (Fejaz Drançolli)

KULLAT E SAHATIT (shek. XVI-XIX). Ndërtimi i tyre filloi me zhvillimin e qyteteve në Kosovë, si në mbarë Perandorinë Osmane, nga shek. XVI-XIX. Kullat e sahatit, si objekte të karakterit shoqëror dhe publik, u ndërtuan nga esnafët e zejtarëve nëpër qendrat qytetare ose në vendbanime me zejtarë të zhvilluar. Ishin objekte arkitektonike dhe teknike me një përhapje të madhe pothuajse në të gjitha qytetet shqiptare, për dallim nga vendet e tjera të rajonit. Ndërtoheshin në vende publike, si në komplekse të çarshive, afër xhamive, në përgjithësi në mjedise të frekuentuara dhe kishin karakter publik. Ora ishte mekanizëm i shpikur në Europën Perëndimore në gjysmën e dytë të shek. XVI. Godinat e kullave kishte bazë katrore ose gjashtëkëndëshe, poligonale. Ishin prej guri, por në disa raste edhe prej druri. Kishin një tipologji ndërtimi, por në



KULLA E SAHATIT NË PRISHTINË

disa raste shfaqeshin edhe në variante të ndryshme. Kulla të sahatit sot kanë ngelur në Prizren, Prishtinë, Rahovec dhe Mamushë. Më parë kishte edhe në Pejë, Vushtrri dhe Gjakovë. Aktualisht ato, në një masë, kanë humbur veçoritë fillestare. Kullat e sahatit dominojnë me monumentalitetin e tyre në vendet ku ekzistojnë ende. (Orges Drançolli)

KULLOTAT. Janë sipërfaqe natyrore, të cilat mbulohen nga një florë natyrore pa përkujdesjen e njeriut. Sipërfaqet me livadhe dhe kulloso në Kosovë janë mjaft të mëdha dhe arrijnë një sipërfaqe prej 261, 388 ha ose 44.65% të sipërfaqeve të tërësishme. Livadhe artificiale e natyrore janë 83,608 ha ose 14. 28%, ndërsa kulloso janë 177,780 ha ose 30.36%. Sipërfaqet më të mëdha me kulloso janë në malet e Sharrit, në Bjeshkët e Nemuna, në bjeshkët e Deçanit, të Gjilanit etj. Kullosoat kanë përparësi të mëdha në krahasim me ushqimet e tjera bimore, sepse janë në gjendje të njomë, me shije të mirë dhe i plotësojnë kërkesat me lëndë ushqyese të shumë llojeve të kafshëve shtëpiake. Shfrytëzimi i ushqimit nga kulloso ka rëndësi për shëndetin e kafshëve, të cilat gjatë kullotjes lëvizin, qëndrojnë në ajër të pastër dhe janë nën ndikimin e rrezeve të diellit, e që ndikon në vitalitetin dhe prodhimtarinë e lartë. Shfrytëzimi i kullosave paraqet mënyrën më ekonomike të të ushqyerit e ripërtypësve dhe të kuajve. (Ragip Kastrati)

KUMBULLA. (*Prunus communis*) Bën pjesë në familjen trëndafilore (*Rosaceae*) dhe i përket pemëve gjetherënëse të grupit bërthamor, ku bëjnë pjesë pjeshka, kajsia, qershia dhe vishnja. Te ne ka qenë kultura më e përhapur, ndërsa me shfaqjen e lisë së kumbullës (*Plum pox virus*), numri ka rënë dukshëm. Pemishtet intensive me sipërfaqet më të madhe me kumbull janë në Gjakovë dhe Ferizaj, ndërsa është e përhapur në kopshtet individuale në tërë Kosovën. Në Kosovë ekziston një numër i konsiderueshëm kultivarësh të kumbullës, që kanë qëndrueshmëri ndaj virusit të lisë: E kaltra e Kalifornisë, Stanley, E hershmja e Bilit, Root gestetner dhe kumbulla vjeshtore. Nënshartesat gjenerative më të përhapurat janë: kumbulla e egër, kulumbria, kumbulla usurijane, pjeshka, kajsia, bajamja dhe nënshtresat vegetative: kumbulla e egër, kumbulla e rëndomtë, kumbulla vjeshtore, pikësi, INRA Juljana GF 655-2, Sen Julien A, Pershor, INRA GF 43, Brompton, Mariana. (Agim Zajmi)

KUPA E ZVEÇANIT. Kupë vullkanike në formë të një kodre, e lartë 797 metra dhe në rrëzën e gjerë afër 300-400 m, në veriperëndim të qytetit të Mitrovicës, në afërsi të vendbanimit të Zveçanit. Është krijuar nga ngurtësimi i lavës viskoze dhe piroklastiteve të aktivitetit vullkanik të terciarit. Kupa e Zveçanit është e ndërtuar nga shkëmbinj të kuarclatiteve të moshës miocen i poshtëm, me ngjyrë të përhimët, me fenokristale të mëdha të kuarcit e sanidinit. (Gani Maliqi)

KUPA Masar (1943-). Piktur. Lindi në Gjakovë. Kreu arsimin bazë në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, studimet për pikturë në Akademinë e Arteve në Prishtinë (1979). Hapi ekspozitat e para vetjake në Gjakovë më 1966 dhe 1968 dhe në Prizren më 1975. Hapi ekspozitën retrospektive me rastin e 50-vjetorit të krijimtarisë në Galerinë e Ministrisë së Kulturës në Prishtinë më 2012. Nga viti 1979 është anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës dhe pjesëmarrës në disa ekspozita të përbashkëta në vend dhe jashtë. Është anëtar dhe bashkëthemelues i Shoqatës të Artistëve të Artit Pamor dhe të Letrarëve “Gjon Nikollë Kazazi” në Gjakovë. (Tahir Emra)

KUQISHTA. Fshat në komunën e Pejës, rreth 23 km në perëndim të saj, në thellësi të

Bjeshkëve të Nemuna, afër kufirit me Malin e Zi. Është fshat tipik malor, me sipërfaqe prej 12 km². Fshati është përfshirë nga valët intensive të shpopullimit. Dikur ishte fshati më i banuar i Rugovës, ndërsa sot (2011) ka vetëm 9 banorë rezidentë. Përveç objekteve receptive turistike, staneve dhe shtëpive të banimit, Kuqishta nuk ka ndonjë objekt të rëndësisë publike. Gjatë pranverës dhe verës banorët merren me blegtori gjysmënomade, me turizëm etj. (Shpend Agaj)

KURBALIU Xheladin (1907-1946). Pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, veprimtar për çlirim kombëtar. Lindi në fshatin Kurbali të Karadakut të Preshevës. Pas Luftës së Parë Botërore familja e tij u shpërngul në Preshevë. Punoi në minierën e kromit në Llojan të Kumanovës, në fillim si punëtor dhe pastaj si kryepunëtor. Aty ra në kontakt me idetë komuniste dhe u pranua në radhët e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Më 1941 iu kundërvu pushtimit bullgar dhe për këtë arsye u detyrua të largohej nga Presheva dhe të vendosej në Gjilan, që i takonte zonës italiane të okupimit. Aty u lidh me komunistët dhe antifashistët. Më 1942 u zgjodh sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së dhe po atë vit u emërua komandant i aradhes së parë partizane shqiptare të Kosovës “Zejnel Hajdini”. Mori pjesë në aksionin e 21 tetorit të vitit 1942 kundër trupave fashiste që ruanin minierën e Llojanit. Shpejt ra në konflikt me politikën e ndjekur nga drejtuesit e PKJ-së. Pas këtij aksioni, tërhiqet dhe vepron në prapavijë. Për një kohë strehohet në Kullë të Kufcës së Poshtme. Pas vendosjes së administrimit ushtarak jugosllav (8 shkurt 1945) iu kundërvu me armë forcave serbe dhe maqedonase në Kosovën Lindore. U vra në përpjekje me forcat e OZN-ës jugosllave në shkurt të vitit 1946, në fshatin Muçibabë të Karadakut. (Fehmi Rexhepi)

KURHASANI Fehim (1950-). Gazetar. Lindi në Gjakovë. Pas përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm në vendlindje, studioi për drejtësi. Filloi të merret me gazetari që nga viti 1973, në programin për të rinj të Radio Prishtinës. Më pas u bë redaktor përgjegjës i programit të dytë të Radio Prishtinës, ku punoi deri në largimin e punëtorëve shqiptarë më 1990. Gjatë viteve '90 ishte gazetar-bashkëpunëtor i Radio-Zagreb, emisionit në gjuhën shqipe dhe korrespondent

nga Peja i gazetës së përditshme “Kosova sot” dhe më pas në gazetën “Dita”. Nga gushti i vitit 1999 është kryeredaktor në Radio-Dukagjinit, si dhe autor dhe udhëheqës i disa emisioneve në këtë radio. (Nehat Islami)

KURSI I KËMBIMIT. Çmimi i valutës së një vendi kundrejt valutës së një vendi tjetër, me rastin e këmbimit ose shndërrimit nga një valutë në valutën tjetër. Kuotimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Kuotimi i drejtpërdrejtë bëhet kur çmimi i një njësie të valutës së huaj shprehet në terma të valutës vendase. Kuotimi i tërthortë bëhet kur çmimi i një njësie të valutës vendase është shprehur në terma të valutës së huaj. Kurset e këmbimit mund të jenë fikse dhe fleksibile (të përcaktuara nga oferta dhe kërkesa për një valutë në treg). Kursi nominal i këmbimit kundrejt partnerëve tregtarë të një vendi, së bashku me çmimet në sektorët e tregtueshëm me këta partnerë, determinon të ashtuquajturën normë reale efektive të këmbimit, që është treguesi real i aftësisë konkurruese të një vendi. Për shkak të përdorimit të valutës euro në Kosovë dhe për arsye të një pjese të madhe të partneritetit tregtar me vendet e eurozonës apo vendet që përcjellin politikën e kursit të këmbimit të ndërlidhur me euro, aftësia konkurruese e Kosovës në tregtinë ndërkombëtare determinohet kryesisht nga çmimet e prodhimeve vendore. (Valentin Toçi)

KURSIMI. Është shuma e mbetur anash, kur nga të ardhurat e individit ose të familjes hiqen të gjitha shpenzimet. Kursimi është një ndër burimet më të rëndësishme të brendshme për financim të investimeve. Zakonisht kursimet paraqiten edhe si përqindje e të ardhurave të disponueshme. Kursimet kombëtare në Kosovë në vitin 2013 kanë qenë rreth 10.5% të prodhimit të brendshëm bruto, kurse në vitin 2014 rreth 11.5% të prodhimit të brendshëm bruto. (Alban Zogaj)

KURSHUMLIU Avni (1947-2017). Inxhinier i makinerisë. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, Fakultetin e Makinerisë në degën e Universitetit të Sarajevës në Mostar (1972). Pas diplomimit filloi punën në kombinatin “Kosova” ku qëndroi deri në pensionim (2012). Gjatë kësaj kohe kreu detyra të ndryshme, si inxhinier i mirëmbajtjes së termocentraleve “Kosova A”, udhëheqës

i shërbimit të mirëmbajtjes dhe drejtori i termocentraleve “Kosova B”. Nga viti 1972 deri më 1983 ishte asistent në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës dhe ligjërues për lëndët përpunimi i materialeve, matjet dhe kontrollet teknike në Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë. Kreu specializime nga energjëtika në vende të ndryshme të Europës dhe në ish-BRSS. Në Nyrenberg të Gjermanisë specializoi për konstruksionin dhe shfrytëzimin e turbinave me avull. Është autor i një sërë publikimesh lidhur me problemet dhe perspektivën e energjetikës në Kosovë. Pas pensionimit u angazhua si ekspert i energjetikës nga koncerni gjerman “Bilfinger” në projektin “Rindërtimi i TC Kosova A-815 MW”. (Fejzullah Krasniqi)

KURTAJ Hajrush (1966-). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Lindi në Gabrricë të Kaçanikut. Kreu shkollën e mesme ushtarake në Beograd, Sarajevë dhe Zarë. Mbaroi studimet për histori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Deri në vitin 1991 shërbeu në ushtrinë jugosllave në Bosnjë dhe në Kroaci. Pas largimit nga ushtria, deri në vitin 1998 punoi në arsim, në Kaçanik dhe në Doganaj. Iu bashkua radhëve të UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes, ku kreu detyrat e komandantit të njësitit të Kaçanikut, pastaj të zëvendëskomandantit të Brigadës 162 “Agim Bajrami”, më pas të komandantit të kësaj brigade dhe të shefit të operativës në Zonën Operative të Nerodimes. Në vitin 1998 u dënua me nëntë vjet burg në mungesë. Pas përfundimit të luftës mbajti pozita të rëndësishme në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës. (Ali Uka dhe Skënder Lutfiu)

KURTAJ Xheladin (1976-1998). Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dëshmor. Lindi në fshatin Gabrricë të Kaçanikut. Më 1995 i filloi studimet për aktrim në Akademinë e Arteve në Prishtinë. Që herët ishte përfshirë në veprimtarinë ilegale. Në pranverë të vitit 1998 la studimet dhe u bashkoi radhëve të UÇK-së në Drenicë. Një kohë u mor me furnizim të armatimit, më pas mori pjesë në betejën në grykë të Carralevës. Më pas kaloi në Zonën Operative të Nerodimes, në zonën e Jezercit dhe në fshatrat e Kaçanikut, ku sërish u mor me furnizim. Në korrik të vitit 1998 nga komanda e zonës u caktua përgjegjës për for-

mimin e policisë ushtarake të UÇK-së për zonën e Kaçanikut. Në natën ndërmjet 9 e 10 gushtit, në shtëpinë e tij në fshatin Gabrricë u rrethua nga forcat serbe dhe pas katër orë luftimesh u vra bashkë me Agim Bajramin dhe Besnik Beguncën. Emrin e tij e mban Shtëpia e Kulturës në Kaçanik. (Halim Emërllahu)

KURTESHI Hamdi (1882-1970). Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare. Lindi në Pozhoran të Vitisë, kreu mejtepin dhe vazhdoi shkollimin në Ruzhdijen e Gjilanit. Më 1907 mori pjesë në luftën kundër komitëve të Serbisë, që u zhvillua në Çebicë, afër Gjylekarit. Që nga ai vit përkrahu dhe bashkëpunoi me xhonturqit. Dha kontribut të çmuar në kryengritjet e vitit 1910-1912. Po ashtu luftoi kundër forcave serbe gjatë luftërave ballkanike. Emigroi në Turqi dhe më pas, deri më 1915 qëndroi në Shqipëri. Pas depërtimit të forcave bullgare në këtë zonë, H. Kurteshi u kthye në vendlindje dhe vazhdoi veprimtarinë kombëtare. Dha kontribut në emancipimin dhe shkollimin e popullsisë fshatare të zonës. Vdiq në Pozhoran. (Blerim Haziri).

KURTESHI Ilaz (1927-2016). Funkionar i lartë politik i Kosovës në periudhën e autonomisë. Lindi në Lubinjë të Poshtme të Prizrenit. Në vitin 1962 mbaroi Shkollën e Lartë Politike



ILAZ KURTESHI

në Beograd. Në moshën 17-vjeçare u rekrutua në njësitë që u dërguan për në Tivar. E mbijetoi masakrën e Tivarit me disa plagë në trup. U kthye në Kosovë dhe më pas u punësua në Trepçë. Ishte udhëheqës sindikal i Trepçës, aktiv në jetën politike dhe ushtroi funksione me përgjegjësi në institucionet e Kosovës në periudhën e autonomisë. Ishte përfaqësues sindikatash në nivel të Kosovës, më pas Kryetar i Kuvendit Krahinor dhe kryetar i komisionit kushtetues të vitit 1974, nënshkruar në Kushtetutën e Jugosllavisë, e cila e njeht Kosovën si të barabartë me pjesë të tjera të Federatës Jugosllave. U rizgjodh kryetar i Kuvendit të Kosovës deri në vitin 1979 dhe më pas deputet federativ dhe kryetar i Kuvendit të Jugosllavisë, si përfaqësues i Kosovës. Mori pjesë në hartimin e Kushtetutës së Kaçanikut (1990) në cilësinë e ekspertit dhe

ishte pjesë e ekipit të dytë negociator për Marrëveshjen e Rambujesë (1999). Në vitin 1998 u zgjodh nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Pas luftës për dy mandate ishte kryetar i Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës (2000-2008). (Daut Bislimi)

KURTI Albin (1975-). Politikan. Lindi në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Si student, në gusht të vitit 1997, iu bashkua Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Ishte njëri ndër udhëheqësit e protestës studentore më 1 tetor 1997, e cila u shtyp brutalisht nga policia serbe. Me fillimin e luftës në Kosovë në gusht të vitit 1998,



ALBIN KURTI

A. Kurti filloi punën në zyrën e përfaqësuesit të përgjithshëm politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Adem Demaçit, ku shërbeu si sekretar i zyrës. Gjatë bombardimeve të NATO-s qëndroi në Prishtinë, deri më 27 prill 1999, kur arrestohet nga policia serbe. Me tërheqjen e forcave serbe në Serbi, më 10 qershor, së bashku me të burgosurit e tjerë shqiptarë u transferua në burgjet serbe. Më 13 mars të vitit 2000, në Gjykatën serbe në Nish, A. Kurti u dënua me 15 vjet burg. Gjatë gjykimit ai refuzoi të njihje legjitimitetin e gjykatës. Si rezultat i presionit ndërkombëtar, A. Kurti u lirua më 7 dhjetor 2001. Më 23 prill 2003, A. Kurti diplomoi në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës, drejtimi i kompjuteristikës me telekomunikacionin. Punoi si aktivist në Rrjetin e Aksionit për Kosovën (KAN) të riaktivizuar në vitin 2003, si lëvizje e aktivistëve të rinj. Më 12 qershor 2005 në muret që rrethonin ndërtesën e UNMIK-ut, aktivistët shkruan parullën “Jo negociata, vetëvendosje!”, që sollti transformimin e KAN-it në Lëvizjen “Vetëvendosje”, ndërsa A. Kurti u zgjodh kryetar. Në vitin 2010 u zgjodh deputet në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 “Vetëvendosje!” fitoi në Prishtinë (2013), ndërsa në zgjedhjet parlamentare të 8 qershorit 2014 doli partia e tretë dhe A. Kurti u zgjodh për herë të dytë deputet i Kuvendit të Kosovës. (Blerim Reka)

KURTI Dom Shtjefën (1898-1971). Titullar i Kishës Katolike. Lindi në Ferizaj. Mësimet e

para i mori në vendlindje, ndërsa gjimnazin e kreu në Shkodër. Studimet për teologji i kreu në Austri (Grac dhe Insbruk) dhe i vazhdoi pas Luftës së Dytë Botërore në kolegjin e Propagandës Fide të Romës. Në vitin 1921 u shugurua meshtar në Romë. Më pas u kthye në vendlindje, ku punoi në zyrën ipeshkvnore, pastaj në Novosellë të Gjakovës. Në vitin 1930, së bashku me Gjon Bisakun dhe Luigj Gashin, i dërguan një peticion sekretarit të përgjithshëm të Ligës së Kombeve në Gjenevë, Erik Drumond, në mbrojtje të shqiptarëve në Kosovë. I kërcënuar nga Mbretëria Jugosllave, më 1930 u detyrua të shkojë në Shqipëri, ku shërbeu si famullitar në Zhejë (Laç, Kurbin) dhe më vonë në Tiranë, si famullitar-dekan i Kishës Katolike për kryeqytetin. U arrestua në vitin 1946 nga regjimi komunist dhe një vit më vonë u dënua me 20 vjet burg. U lirua në vitin 1963, u burgos dhe u lirua përsëri nga burgu i Burrelit në vitin 1966. U arrestua përsëri më 1970 dhe u dënua me vdekje, me arsyen se kishte guxuar të pagëzonte një fëmijë. U pushkatua më 20 tetor 1971, në një vend që as sot nuk dihet. Dom Shtjefën Kurti është njëri ndër 40 kandidatët martirë shqiptarë, që pritet të kanonizohen nga Vatikani. (Gjon Berisha)

KURTISHI Hafiz Abdylaziz (1853-1917). Myderriz, myfti, bibliofil dhe epigrafist. Lindi në Krushë të kazasë së Gorës. Pasi mbaroi shkollën fillore në Prizren, studimet i vazhdoi në Stamboll. Në vitin 1891 u emërua myderriz dhe drejtor i Medresesë së Mehmet Pashës në Prizren, detyrë që e ushtroi për afro tri dekada. Te Abdylaziz Efendiu u diplomuan shumë studentë nga të gjitha hapësirat shqiptare. Ishte edhe myfti i Prizrenit. Kishte në pronësi një bibliotekë shumë të pasur me libra dhe dorëshkrime. Një pjesë e kësaj biblioteke sot ruhet në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Është autor i disa veprave në dorëshkrim nga fusha e teologjisë dhe e jurisprudencës islame. Është autor i kronogramit të rindërtimit të Xhamisë së Sinan Katibit në Prizren. (Sadik Mehmeti)

KUSARI Kadri (Dush) (1935-1984). Veprimtar i lëvizjes ilegale, i burgosur politik. Lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në vendlindje. Një vit punoi si mësues dhe më pas kreu studimet për gjuhë dhe letërsi



KADRI KUSARI

shqipe në degën e albanologjisë në Universitetin e Beogradit. Pas studimeve nis punën e mësimdhënësit në gjimnazin e porsahapur të Gjakovës, ku punoi deri në vitin 1962, kur pushohet nga puna si i papërshtatshëm politikisht. Një vit më vonë i jepet mundësia të zërë punë si përkthyes në ndërmarrjen ndërtimore “Dukagjini”. Përfshihet në veprimtari ilegale, në organizatën “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”, e cila udhëhiqej nga Adem Demaçi. U zgjodh udhëheqës i degës së kësaj organizate në Gjakovë. Bashkëveproi me disa intelektualë të asaj kohe, si: Avni Lama, Myrteza Nura, Teki Dervishi, Ramadan Shala etj., me të cilët kishte formuar grupin ilegal. Në qershor të vitit 1964 grupi dekonspirohet dhe anëtarët burgosen. Si udhëheqës i grupit, K.Kusari u dënua me 11 vjet burgim të rëndë, prej të cilave i vuan shtatë vjet. Disa vjet më vonë sërish punësohet si përkthyes në fabrikën e tekstit “Emin Duraku” në Gjakovë. Ishte i njohur për qëndrimin e tij të paluhatshëm, ndonëse u izolua dhe u mbajt nën vëzhgimin e kujdesshëm të organeve të sigurimit shtetëror. Sa herë që përkeqësohej situata politike në Kosovë, ai izolohej në burg, si person me rrezikshmëri të lartë. Vdiq në Gjakovë dhe në varrimin e tij morën pjesë mijëra qytetarë nga mbarë Kosova. (Arbër Salihu)

KUSARI Sami (1939-1999). Inxhinier i xehetarisë. Lindi në Gjakovë, shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Gjakovë, studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe të Gjeologjisë të Universitetit të Beogradit (1964). Filloi punë në minierën e kromit “Deva” në Gjakovë si inxhinier (1964-1967), më pas bëhet drejtor në minierën sipërfaqësore të qymyrit “Bardh i Madh”, në kuadër të Kombinatit xehetar-energjetik “Kosova” të Obiliqit (1967-1972). Në vitin 1973 emërohet drejtor i minierave të hekur-nikelit në ndërmarrjen në themelim “Ferronikeli” në Drenas. Kreu edhe një varg funksionesh të tjera udhëheqëse. U mor kryesisht me projekte profesionale nga lëmi i minierave. Ishte pjesëmarrës në disa kongrese dhe konferenca shkencore nga lëmi i xehetarisë brenda dhe jashtë vendit. (Shyqeri Kelmendi)

KUSHTETUTA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Akti më i lartë juridik i Bashkësisë Islame të Kosovës, i miratuar në vitin 2002, i ndryshuar dhe i plotësuar në vitin 2013. Ka gjithsej 83 nene të ndarë në dhjetë kapituj. Sipas kësaj Kushtetute, saktësohet se Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës është bashkësi e vetme dhe unike islame e të gjithë pjesëtarëve të këtij besimi të rajonit të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës, Ferizajt, Preshevës dhe Gjakovës si dhe e pjesëtarëve të Bashkësisë Islame që gjenden me punë dhe qëndrim në botën e jashtme. Me kushtetutë rregullohet veprimtaria e Bashkësisë Islame të Kosovës, saktësohet qëllimi i saj që pjesëtarët ta ruajnë dhe ta zhvillojnë jetën fetare të myslimanëve dhe të punojnë në ngritjen shpirtërore, kulturore dhe social-ekonomike të tyre. Në kapitujt vijues përshkruhen të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve të Bashkësisë Islame, prona dhe objektet e saj. Sipas këtij dokumenti, të gjithë pjesëtarët e besimit islam janë të barabartë, pa dallim përkatësie nacionale, racore dhe gjinore. Me kushtetutë janë përcaktuar edhe organet dhe institucionet e Bashkësisë Islame, sistemi zgjedhor dhe mënyra e zgjedhjes në organet përkatëse të Bashkësisë Islame. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera normative të Bashkësisë Islame të Kosovës duhet të jenë të harmonizuara me dispozitat e këtij dokumenti themelor. (Resul Rexhepi)

KUSHTETUTA E KAÇANIKUT (1990).

Kushtetutë e Republikës së Kosovës, e miratuar më 7 shtatorit 1990 nga Kuvendi i Kosovës, e njohur sipas vendit të shpalljes së saj. Përbënte hapin e dytë të akteve konstitutive kushtetuese dhe politike (pas Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut), me të cilat u përcaktuan bazat e shtetësisë dhe pavarësisë së Kosovës. Me këtë akt, në të vërtetë, shprehej avancimi i pozitës kushtetuese-politike të Kosovës nga njësi autonome në njësi të pavarur, në kuadër të bashkësisë së Jugosllavisë. Kushtetuta përbëhej nga pjesa hyrëse dhe pjesa normative. Në preambulë theksoheshin shkaqet e miratimit të Kushtetutës dhe qëllimet e saj. Pjesa normative përbëhej nga 9 pjesë të shpërndara në gjithsej 140 nene. Në dispozitat e përgjithshme, Republika e Kosovës përkufizohej si “shtet demokratik i popullit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare të serbëve,

myslimanëve, malazezëve, kroatëve, turqve, romëve e të tjerëve që jetojnë në Kosovë”. Kushtetuta e Kaçanikut e shihte Kosovën si “anëtare të bashkësisë së Jugosllavisë” dhe e shprehte orientimin e saj për barazi me njësitë e tjera federale të ish-Jugosllavisë. Në dispozitat e tjera të përgjithshme përcaktohej pozita e qytetarit, si bartës i pushtetit, organizimi shtetëror i Republikës së Kosovës dhe atributet e shtetësisë së saj. Si organe kryesore të Republikës së Kosovës përcaktoheshin: Kuvendi i Republikës, Kryesia e Republikës, Qeveria e Republikës, gjyqet dhe prokuroritë publike, Banka Popullore dhe Gjyqi Kushtetues i Kosovës. Me Amendamentin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1991, institucioni i Kryesisë u zëvendësua me kryetarin e Republikës, si shef individual i shtetit. Lidhur me ndryshimin e Kushtetutës përcaktoheshin zgjidhjet e njëjta me ato që i parashihte Kushtetuta e KSA të Kosovës e vitit 1974. Megjithatë, kishte një përjashtim: mundësia e ndryshimit të Kushtetutës me referendum. (Esat Stavileci)

KUSHTETUTA E KSA TË KOSOVËS (1974).

Kushtetutë e Krahinës Socialiste Autonome (KSA) të Kosovës, me të cilën u avancua pozita kushtetuese dhe politike e Kosovës dhe të drejtat e shqiptarëve në shtetin federativ jugosllav. Dispozita të caktuara për KSA të Kosovës përmbante edhe Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) dhe Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë. Sipas Kushtetutës së RSFJ-së, pozita kushtetuese-politike e KSA të Kosovës ishte e ngjashme, por jo dhe e barabartë, me atë të republikave socialiste. Kosova gëzonte shkallë të lartë të autonomisë në fushën kushtetutëdhënëse dhe legjislativë, në fushën territoriale, në atë financiare dhe ekonomike, në fushën gjyqësore, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në fushën e ruajtjes së rendit e të sigurisë dhe të mbrojtjes popullore. Megjithatë, edhe pse ishte pjesë konstitutive e Federatës Jugosllave, Kosova ishte njëkohësisht e strukturuar në kuadër të Serbisë. Statusi i Kosovës ishte hibrid: në njërin anë me tendencë për mbajtjen e saj në suazat kushtetuese të Serbisë dhe në anën tjetër për pozicionimin e saj plotësisht të barabartë në Federatë. Strukturimi i Kosovës në Serbi binte ndesh me pozitën e saj në raportet në Federatë. Kosova ishte pjesë përbërëse e Federatës së ish-Jugosllavisë,

kishte territorin dhe kufijtë e vet, që nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e saj, ishte e përfaqësuar në të gjitha organet dhe organizatat e Federatës, merrte pjesë në marrëdhënie me organet dhe organizatat ndërkombëtare, ndërsa kishte pozitë të barabartë me ish-republikat në procedurën e nxjerrjes dhe të ndryshimit të Kushtetutës së Jugosllavisë. Me gjithë pohimet serbe, Kosova nuk ishte “pjesë e Serbisë”, gjë që paraqitej si pengesë për avancimin e saj si njësi e barabartë federale me republikat e tjera. Nuk ishte as në përbërjen e shtetit sovran dhe të pavarur të Serbisë në Kongresin e Berlinit (1878) dhe as ishte inkuadruar në Serbinë sovranë dhe të pavarur. Pra, një pozicion i tillë i Kosovës në “kuadrin e Republikës së Serbisë” nuk ishte në përputhje me vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Pushteti serb nga mesi i viteve ’80 të shekullit të kaluar, përmes të të ashtuquajturit “Libër i Kaltër” dhe më vonë përmes Memorandumit të Akademisë së Shkencave të Serbisë filloi përgatitjet për shfuqizimin e Kushtetutës së KSA të Kosovës të vitit 1974, proces që kulmoi më 5 korrik të vitit 1990, kur ajo praktikisht nuk ishte në fuqi, pas vendosjes së masave të dhunshme të Qeverisë së Serbisë në Kosovë dhe shpërndarjes së institucioneve të KSA të Kosovës, të ndërtuara sipas Kushtetutës së saj të vitit 1974. (Esat Stavileci)

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (2008). Akti themelor juridik dhe politik i Republikës së Kosovës, që rregullon pozitën kushtetuese dhe bazat e sistemit politik, eko-



NËNSHKRIMI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (15 QERSHOR 2008)

nomik dhe shoqëror, organizimin e brendshëm, si dhe raportet me subjektet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare. Kushtetuta u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më

9 prill 2008, ndërsa hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta paraqet një dokument modern, që promovon një shtet të pavarur dhe sovran me të gjitha vlerat europiane të një demokracie kushtetuese. Në procesin e hartimit të kushtetutës ishin të përfshirë juristë vendorë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Kushtetuta promovon vlerat më të larta qytetëruese dhe demokratike dhe një sistem ku krahas qeverisjes së shumicës siguron mekanizma të fuqishëm për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. E bazuar në frymën e Pakos së Ahtisarit, kushtetuta promovon opsionin europian të shtetit të Kosovës të bazuara në standarde të larta demokratike dhe vizione për rrugën e qartë të integrimeve euroatlantike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës kaloi një proces të vështirë në fazën e hartimit të saj, sepse, në njërin anë paraqiste aspiratën shekullore të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, pastaj elementet qenësore të mbrojtjes së identitetit kombëtar e shtetëror, ndërsa nga ana tjetër, reflektonte edhe kompromisin politik ndërkombëtar, duke u bazuar në elementet kryesore të Pakos së Ahtisarit, në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Procesi i informimit dhe i konsultimit me qytetarë të Kosovës u zhvillua në periudhën prej 19 shkurtit deri më 4 mars 2008 në shumicën e qyteteve të Kosovës, me ç'rast u bënë një sërë komentimesh, vërejtjesh dhe sugjerimesh për plotësimin dhe përmirësimin e projektkushtetutës së propozuar, të cilat u morën për bazë dhe një pjesë e tyre gjetën vend në versionin e përmirësuar të projektkushtetutës. Ndërsa elementet kryesore të propozimit gjithëpërfshirës nuk mund të ndryshoheshin dhe, si të tilla, u inkorporuan fjalë për fjalë në projektkushtetutë.

Kushtetuta e Kosovës ka karakter konstitutiv apo themelues, sepse pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe procesit të përcaktimit të statusit final, me shpalljen e shtetit të Kosovës u realizua aspirata historike për vetëvendosje, liri dhe pavarësi. Janë tri objektiva politike që synonte t'i arrinte kjo Kushtetutë: (1) misionin historik të themelimit të shtetit sovran dhe të pavarur të Kosovës; (2) promovimin e vlerave të një shteti demokratik të bazuar në një demokraci kushtetuese funksionale, parlamentarizëm të ekuilibruar, të bazuar në ndarjen dhe kontrollin reciprok të

pushteteve dhe parimin e sundimit të ligjit dhe (3) përcaktimin e qartë të Kosovës për orientim në agjendën e integrimeve euroatlantike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si kushtetutë konstitutive, paraqet një kushtetutë moderne, e cila i është përmbajtur në tërësi standardeve në aspektin e përmbajtjes që sot aplikohen për kushtetutat në përgjithësi, duke përfshirë respektimin e plotë të parimit të mosdiskriminimit, parimin e ndarjes dhe të kufizimit reciprok të pushteteve, barazisë së qytetarëve para ligjit dhe mbrojtjen e minoriteteve, raportin e shtetit me religjionin, karakterin laik të shtetit, parimin e sundimit të ligjit, sfondin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe mekanizmat ligjorë, kontrollin civil ndaj policisë dhe ushtrisë, gjyqësor të pavarur, ratifikimin dhe zbatimin e konventave europiane për të drejtat e njeriut, ndalimin e torturës, gjykimin e drejtë dhe korrekt, heqjen e dënimit me vdekje etj. Kushtetua e Republikës së Kosovës është e hartuar mbi frymën e parimeve të përgjithshme të promovuara nga të gjitha kushtetutat e shteteve demokratike, ku përfshihen parimi i supremacisë kushtetuese, parimi i sundimit të ligjit, parimi i enumeracionit taksativ të juridiksionit kushtetues, parimi i demokracisë kushtetuese dhe parlamentare, parimi i ndarjes dhe i kontrollit të pushteteve, parimi i diskriminimit pozitiv, parimi i rishikimit gjyqësor të legjislationit, parimi i prezumimit absolut të lirisë së qytetarit dhe shtetasit, parimi i pavarësisë së gjyqësorit etj. Kushtetuta e Republikës së Kosovës edhe pse në pikëpamje të plotësimin të standardeve dhe parimeve demokratike avancojnë në krahasim me kushtetutat e shumë vendeve të tjera, në aspektin praktik, në raport me vitet e ekzistencës së saj është përballur dhe sfiduar pareshtur në kuptim të zbatimit dhe të shmanגיעve të dispozitave të saj nga subjekte dhe kategori të ndryshme kushtetuese, duke sprovuar kështu edhe vetë rendin kushtetues dhe ligjor që përcakton ajo. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka gjithsej 162 nene të sistemuar në kapituj dhe struktura e saj bazohet në një arkitekturë standarde dhe moderne të kushtetutave. Kushtetuta është burim themelor i së drejtës në Republikën e Kosovës, me të cilën duhet të jenë në përputhje të gjitha ligjet dhe aktet e tjera normative. (Arsim Bajrami)

KUTLESHI Arif (1956-). Poet, prozator, përkthyes. Lindi në fshatin Dumosh të Podujevës.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Podujevë, ndërsa studimet universitare në Prishtinë. Shkruan poezi dhe prozë dhe merret me përkthime. Me punime letrare është paraqitur qysh herët në periodikun tonë. Ka botuar këto vepra me poezi: “Lojë e përjetshme” (1987), “Perdja e diellit” (1990), “Jeta nuk është reale” (1996), “Malli për fluturim” (1999), “Herbarium Illyricum”, (2009) “Aqua Ludens” (2012). A. Kutleshi shkruan edhe tregime dhe ka të botuara romanet “Kënaqësia e afërsisë së padurueshme” (2003) dhe “Princesha e Labeatisë” (2015). Poezitë e tij janë botuar edhe gjermanisht dhe slovenisht dhe është prezantuar në antologjinë e krijuesve të huaj në Austri. Përveç me krijimtari letrare, A. Kutleshi merret edhe me përkthime letrare. Nga gjermanishtja në gjuhën shqipe ka përkthyer romanin “Kryqi i Adamit” të Alice Mead, “Disertacionin e Lasgush Poradecit mbi Eminecun” si dhe librin “Shqipëria katolike e Veriut” nga Baron Nopcsa. (Nazmi Rrahmani)

KUTLLOVCI Enver (1960-). Ekonomist, profesor universiteti. Lindi në Dardhishtë (Obiliq), studimet universitare, përfshirë edhe tezën e doktoratës në fushën menaxhmentit, i



ENVER KUTLLOVCI

përfundoi në Fakultetin Ekonomik të Universitetin e Prishtinës. Më pas u zgjodh asistent e më vonë profesor po në këtë fakultet, duke ushtruar njëkohësisht funksione me rëndësi në institucionet e shkollimit të lartë në Kosovë. Është autor dhe bashkautor i disa librave dhe teksteve shkollore dhe universitare, si: “Menaxhimi i resurseve humane” (2004), “Biznesi i vogël dhe i mesëm” (2006), “Menaxhimi i resurseve njerëzore (Qasja strategjike)” (2014) etj. Ka botuar edhe artikuj në revista shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Aktualisht ligjeron lëndët menaxhim i resurseve njerëzore, menaxhim strategjik dhe menaxhim të projektit në studimet baçelor dhe master. (Besnik Krasniqi)

KUTLLOVCI Imer (1978-). Aktor. Lindi në Prishtinë, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Mbaroi studimet për aktrim në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës (2002).

Fillimisht luajti në disa shfaqje në Teatrin “Dodona” dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Më 2005-2006 vazhdoi studimet në Konservatorin Nacional të Artit Dramatik në Paris. Në Teatrin Comédie Français luajti në shfaqjet “Kthimi në shkretëtirë” (2006), “Martesa e Figaros” (2007), “Ubu Roi” (2009) etj. Ndërsa në Théâtre Ciné13 luajti në shfaqjen “Hamleti” (2009), në Théâtre Mouffetard në shfaqjen “Ëndrrat” (2009), pastaj në Théâtre du Marais në shfaqjen “Romeo dhe Zhuljeta” (2012), në Théâtre des Lilas et Studio d’asnières në “Lagja e zezë” (2013) etj. Luajti në filmat: “Grabitja e armatosur”, “Coline”, “Zgjedhja e Adeles”, “Bici” etj., si dhe në serialet televizive franceze “Ingranazhi”, “Braqu” etj. Luajti edhe në disa filma të metrazhit të shkurtër. Jeton dhe punon në Paris. (Erson Zymberi)

KUTLLOVCI Muharrem (1938-2000). Mjek, infektolog, profesor universitar. Lindi në fshatin Dardhishtë (ish-Krushec), komuna e Obiliqit. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje dhe Prishtinë, kurse Fakultetin e Mjekësisë e përfundoi në Shkup (1967). Fillimisht u punësua në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, në repartin e infektivës (më vonë në Klinikën e Sëmundjeve Ngjitesë). Specializimin nga infektologjia e kreu në Zagreb, tezën e doktoratës e mbrojti në Prishtinë (1978). Ndërkohë, më 1972 u zgjodh asistent i lëndës së sëmundjeve infektive në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Përveç punës profesionale dhe pedagogjike dha kontribut të çmuar në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve shëndetësore dhe arsimore në Klinikën e Sëmundjeve Ngjitesë dhe në Fakultetin e Mjekësisë. M. Kulllovci ishte profesor ordinar dhe u shqua për punë intensive në ngritjen profesionale të institucioneve shëndetësore në Kosovë, veçmas në fushën e infektologjisë. Botoi shumë punime shkencore dhe profesionale, si autor dhe bashkautor. (Muharrem Bajrami)

KUVENDET SHQIPTARE DHE NDËR-BALLKANIKE. Tubime të rëndësishme të përfaqësuesve shqiptarë dhe ballkanas për organizimin e luftës kundër sundimit osman. I pari ndër kuvendet shqiptare u mbledh në Lis të Matit (Manastiri i Shën Mërisë) më 7 nëntor të vitit 1584. Kuvendi miratoi një projekt për kryengritje, i cili iu paraqit Papës së Romës, por ky i fundit u përgjigj se ende nuk ishte koha për

veprime të tilla. Duke marrë shkas nga hyrja në luftë e shteteve europiane me osmanët (1595), përfaqësuesit shqiptarë thirrën një kuvend të dytë në Blinisht të Lezhës më 1598. Mirëpo edhe vendimi i këtij kuvendi për kryengritje nuk gjeti mbështetje nga shtetet e Perëndimit. Megjithatë, nismëtarët e këtyre tubimeve u treguan këmbëngulës në idenë e tyre. Në vitin 1601 një tjetër kuvend u mbledh në Dukagjin të Matit. Përpjekje për të bashkërenduar lëvizjen kundërosmane u bënë edhe në nivel ballkanik. Kuvendi i parë ndërballkanik u mbajt në Kuç (sot në Mal të Zi) më 1614. Në këtë tubim morën pjesë përfaqësues të kryengritësve nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina. Pjesëmarrësit e kuvendit përpiluan një strategji të detajuar për fuqizimin e vatrave kryengritëse në Ballkan, por përsëri mungoi përkrahja e duhur e shteteve të Europës. Megjithatë, përfaqësuesit e këtyre vendeve thirrën një kuvend të dytë në Prokuplje më 11 nëntor 1616. Një rol qendror në luftën çlirimtare kundërosmane kuvendi i dha faktorit kryengritës shqiptar. Një tjetër kuvend i përfaqësuesve ballkanas u thirr në Beograd më 18 nëntor 1620, por edhe këtë herë munguan si aftësia e duhur për bashkëveprim, ashtu edhe ndihma europiane. Për rrjedhojë, nismat e lartpërmendura mbetën të perealizuara. (Ferit Duka)

KUVENDI I DOBËRDOLIT (1945). Kuvend i krerëve të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare dhe i atyre që nuk u pajtuan me rikthimin në Kosovë nën pushtetin e Jugosllavisë komuniste. Ishte një përpjekje për riorganizimin e rezistencës dhe luftës antijugosllave në Kosovë, pas shpartallimit të forcave të Shaban Palluzhës. Kuvendi i zhvilloi punimet më 4-5 gusht 1945 në Dobërdol të Klinës. Në të morën pjesë 19 grupe ilegale dhe përfaqësues të Rozhajës dhe të Pazarit të Ri, gjithsej 158 veta. Kuvendin e hapi Ukë Sadiku, fjalën hyrëse e mbajti Ymer Berisha, ndërsa procesmbajtëse ishte Marie Shllaku. Në Kuvend folën shumë pjesëmarrës, si Ukë Sadiku, Ymer Berisha etj. Folësit u angazhuan për nevojën e organizimit të përbashkët në luftë kundër brigadave partizanëve dhe pushtetit të tyre. Për shkak të sigurisë, dita e dytë e Kuvendit vazhdoi në një lokalitet tjetër, afro 1.5 km më larg. Ditën e dytë mbledhjen e hapi Ndue Përlleshi, ndërsa Ymer Berisha foli

përsëri për bashkimit e forcave gjithëshqiptare në të gjitha viset në luftë të përbashkët kundër pushtetit të ri. Kuvendi zgjodhi Ymer Berishën udhëheqës politik, e Ukë Sadikun udhëheqës ushtarak. Gjithashtu u zgjodhën udhëheqësit politikë dhe ushtarakë për të gjitha zonat. U zgjodh kryesia prej 12 vetash, që më vonë u quajt “12 Këshillat” e Kuvendit të Dobërdolit. (Lush Culaj).

KUVENDI I DRENICËS (1944). Kuvend për organizimin e forcave vullnetare në Drenicë, për formimin e Brigadës së Drenicës për luftë kundër forcave komuniste jugosllave. Në këtë kuvend u diskutuan tri pika kryesore: të mbrohen kufijtë e shtetit të përbashkët me Shqipërinë, të bëhet mobilizimi i rekrutëve antikomunistë dhe të zgjidhet udhëheqja e kuvendit. Kuvendi i zhvilloi punimet në Polac të Skënderajt. Në të morën pjesë 200 delegatë nga Drenica dhe viset e tjera të Kosovës. Përfaqësuesit kryesor ishin: Shaban Polluzha, Mihtar Bajraktari, Halil Haxhiu, Marie Shllaku, Ymer Berisha, Mehmet Gradica, Ahmet Shala etj. Brigada e Drenicës u formua pas mbajtjes së këtij kuvendi, ku për komandant u emërua Shaban Polluzha. Në kuvend u përfaqësuan 23 fshatra të Drenicës Veriperëndimore, ndërsa përfaqësuesit e Drenicës Juglindore nuk pranuan të merrnin pjesë në luftë kundër njësiteve partizane të UNÇJ-së. (Skënder Lutfiu).

KUVENDI I DUKAGJINIT (1601). Një nga tubimet e rëndësishme të përfaqësuesve shqiptarë për organizimin e luftës kundër sundimit osman. Ishte kuvendi i tretë i cili u mbajt pranë Kishës së “Shën Lleshit” në fshatin Dukagjin të Matit. Kuvendi i Dukagjinit dallohej nga tubimet e mëparshme të kësaj natyre si për kohën e zgjatjes së punimeve (vijuan edhe në vitin 1602), ashtu edhe për gjeografinë e gjerë të përfaqësimit të shqiptarëve. Në kuvend morën pjesë mbi 2,600 përfaqësues laikë e fetarë nga Kosova, Malësia e Shkodrës, Dukagjini, Zadrima, Lezha, Kurbin, Mati, Dibra, Tirana, Durrësi, Elbasani, Myzeqeja etj. Protagonistë kryesorë të tubimit ishin Nikollë Mekajshi (peshkop i Stefanisë), Nikollë Bardhi dhe Gjin Gjergji. Vendimi kryesor i kuvendit lidhej me fillimin e luftës çlirimtare kundër sundimit osman. Për këtë qëllim u vendos që të kërkohej ndihmë nga shtetet perëndimore, në radhë të parë nga Venediku. Nikollë Bardhi

dhe Pal Dukagjini u ngarkuan nga kuvendi që t'i përcillnin Republikës së Shën Markut kërkesën për ndihma financiare dhe armatime për kryengritësit shqiptarë. Mirëpo nga Senati i Republikës edhe këtë herë morën përgjigjen se ende nuk ishte koha për kryengritje kundërosmane. Përballë refuzimit të ndihmës nga Venediku, përfaqësuesit shqiptarë deklaruan se do t'i drejtoheshin për ndihmë Spanjës. Por kjo nuk u realizua, pasi në radhët e tyre filloi përçarja dhe në këtë mënyrë rezultoi pa sukses edhe projekti i dalë nga Kuvendi i Dukagjinit. (Ferit Duka)

KUVENDI I FERIZAJT (1908). Mbledhje e krerëve të vilajetit të Kosovës, në mbështetje të xhonturqve dhe për të shpëtuar vendin nga copëtimi i mëtejshëm. Kuvendi u mbledh në kushtet, kur nga Kaçaniku deri në Lipjan ishte zënë nga shqiptarët e armatosur. Situata ishte tensionuar pas marrëveshjes anglo-ruse rreth reformave në Maqedoni dhe lajmit se Porta e Lartë do t'u shiste austriakëve tokat rreth Ferizajt për vendosjen e kolonëve. Kjo bëri që në Ferizaj të tuboheshin banorët e rrethinës së këtij vendbanimi dhe të viseve të tjera të vilajetit të Kosovës. Sipas të dhënave konsullore austriake më 15 korrik 1908 këtu ishin tubuar rreth 30,000 persona të armatosur. Ky ishte tubimi më i madh i shqiptarëve të vilajetit të Kosovës pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në Ferizaj u mbledhën krerët nga të gjitha sanxhaqet e Vilajetit të Kosovës, midis të cilëve ishin Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Ferhat bej Draga nga Mitrovica, Nusret Beu nga Jeni Pazari, Sulejman Batusha, Ramadan Zaskoku nga Luma, Musa Miftari nga Budakova, Qerim Mahmut Begolli nga Peja, Jahja Beu nga Prizreni, Zejnullah Beu nga Prishtina, Jakup Beu nga Tetova, Ramë Abdyl nga Pozharani etj. Mbledhja e parë në Kuvendin e Ferizajt u mbajt më 14 korrik, ku përfaqësuesit u shprehën kundër ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në projektin e reformave që rrezikonin copëtimin e viseve shqiptare dhe për masat që duheshin marrë për mbrojtjen e vendit nga sulmet e jashtme. Konsulli serb në Prishtinë Peqanac, raportonte se më 15 korrik në Kuvend ishte diskutuar edhe çështja e formimit të Shqipërisë autonome. Për të tërhequr këtë masë të madhe kryengritësisht shqiptarë, Komiteti "Bashkim dhe Përparim" me qendër në Selanik dërgoi emisarët e vet në

Kuvendin e Ferizajt. Në krye kishte vendosur Galip Beun, komandant i xhandarmërisë së Shkupit. Pas konsultimesh të gjata, më 20 korrik u arrit marrëveshja që shqiptarët t'i bashkohen revolucionit xhonturk. Në këtë ndikoi edhe qëndrimi i përgjithshëm i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i komiteteve dhe i çetave të armatosura shqiptare, që tashmë qenë bashkuar me Revolucionin xhonturk. Kuvendi i Ferizajt i dërgoi sulltan Abdyl Hamitit një telegram, me të cilin kërkohej rivendosja e menjëhershme e Kushtetutës së vitit 1876 dhe thirrja e mbledhjes së parlamentit. Më 22 korrik iu dërgua sulltanit një telegram tjetër, me kërcënimin se, nëse nuk shpallej kushtetuta, do të fillonte marshimi i shqiptarëve të armatosur drejt Stambollit. Sulltan Abdyl Hamiti, më në fund, u detyrua të shpallte Kushtetutën e vitit 1876, apo Hyrijetin (Lirinë), natën e 23-24 korrikut 1908. Bashkimi i ushtrive me xhonturqit, sidomos i ushtarëve dhe oficerëve të Armatës II të Maqedonisë, shumica e të cilëve ishin shqiptarë, dhe përkrahja e kryengritjes nga Kuvendi i Ferizajt, ishin faktor të rëndësishëm që përcaktuan fitoren e revolucionit xhonturk. (Aliriza Selmani)

KUVENDI I FISEVE. Organi ryesor në sistemin e vetëqeverisjes fisnore në Malësinë e Veriut. Kuvendi i fiseve ka marrë vendime të rëndësishme për çështjet që kanë pasur të bëjnë me interesin e përgjithshëm të shoqërisë pa shtet, që funksiononte sipas normave kanunore. Për shkak të rrethanave specifike të pushtimit, përveç në Rrafshin e Dukagjinit dhe anës së Rugovës, kuvendi i fiseve ka luajtur rol gjithandej Kosovës, sidomos para organizimit të kryengritjeve popullore. Pas kësaj kuvendi i fiseve evoluon natyrshëm në këshillin e bajraqeve. Derisa kuvendi i fisit përbëhej nga përfaqësues legjitimë të vëllazërive, të katundit ose komunitetit, kuvendi i fiseve mbledhte kryefisnorë që zinin vend dhe pozita sipas hierarkisë legjitime, të miratuar dhe të respektuar nga të gjitha fiset. Kuvendi ka qenë institucion, i cili u ka mundësuar klaneve dhe grupeve të tjera të organizuara të vepronin kolektivisht për të gjetur zgjidhje për problemet e ndryshme, për grindjet dhe konfliktet ndërfitnore, ose për të marrë vendime me karakter rajonal fisnor. Konfliktet brenda një fisi zakonisht ishin çështje e vetë fisit. Si institucion unifikues i fisit, Kuvendi i

fisit përbëhej nga të gjithë kryetarët e familjeve të fisit nën drejtimin e kreut të fisit, i cili rridhte nga djali i parë i themeluesit të fisit. Plaku i fisit ishte kreu i fisit të vet dhe kishte të drejtë të thërriste në kuvend nga një burrë për shtëpi, ose vetëm krerët e familjeve të fisit. Për dallim nga ky organ, kuvendi i fiseve i tubonte të gjithë kryefisnorët legjitimë në situata që u paraprinin marrjes së vendimeve të mëdha dhe me interes për krejt rajonin. (Anton Vukpalaj)

KUVENDI I JUNIKUT (1912). Tubim i përfaqësuesve të viseve shqiptare, i mbajtur nga 21-25 maj 1912 në Junik, ku u përgatit kryengritja e përgjithshme kundër sundimit osman dhe u morën nisma për realizimin e vendimeve të Mbledhjes së Taksimit. Në këtë kuvend fjalën kryesore e kishte paria e Kosovës, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Riza bej Gjakova, Jashar Pasha, Hasan Feri, Isa Boletini, Zejnullah Vuçitërna etj. Në të morën pjesë ndërmjet 200-400 përfaqësues nga shumica e viseve të vilajetit të Kosovës, nga Sjenica, Berana, Pazari i Ri, Dibra dhe vilajeti i Shkodrës. Munguan përfaqësues nga kazaja e Shkupit dhe ajo e Gjilanit, të cilët njoftuan Kuvendin që do t'i pranonin vendimet e tij. Pas mospajtimeve të ndryshme, delegatët mbështetën thirrjen e Hasan Prishtinës për një kryengritje të përgjithshme, në mënyrë që ta detyronin qeverinë e Stambollit t'ua njihje autonominë shqiptarëve. Në Kuvendin e Junikut u përpunua edhe plani i veprimeve luftarake, për të realizuar platformën politike të autonomisë. Kërkesat që dolën nga Kuvendi i Junikut ishin: 1. Caktimi i kufijve politikë të Shqipërisë; 2. Në vend të flamurit të Turqisë të vendosej flamuri i Shqipërisë; 3. Emërimi i një sundimtari të përgjithshëm në Shqipëri, i cili do të zgjidhej nga familjet e njohura shqiptare; 4. Në vend të nëpunësve të huaj në Shqipëri, të vihen nëpunës shqiptarë; 5. Përdorimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare; 6. Realizimi i këtyre kërkesave të jetë i garantuar nga Fuqitë e Mëdha. Kuvendi i Junikut përfundoi me urdhrin që kryengritësit të sulmonin të gjitha qytetet e tjera, në radhë të parë Pejën. Më pas u lidh besa dhe iu bë thirrje popullit shqiptar që t'i bashkohej kryengritjes së armatosur. Kërkesat që dolën nga Kuvendi i Junikut, në formë promemorie, iu dërguan qeverisë në Stamboll dhe përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha dhe shteteve të tjera. Kuvendi ndikoi në zgjerimin lëvizjes së armatosur në të gjitha viset shqiptare dhe

bashkimin e forcave përparimtare për të vënë në jetë programin e tij politik. (Fitim Rifati)

KUVENDI I KAÇANIKUT. Mbledhje e Kuvendit të Kosovë për aprovimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në Kaçanik, më 7 shtator 1990, në kushtet e një aksioni të



MBLEDHJA E KUVENDIT TË KOSOVËS NË KAÇANIK, MË 7 SHTATOR 1990

gjerë të sigurimit serb dhe në besim të madh të popullatës vendëse, u mbajt seanca e përbashkët e të tri dhomave të Kuvendit të Kosovës. Delegatët arritën në këtë seancë "si kishin ditur dhe si kishin mundur", të mbrojtur dhe të orientuar nga qytetarët e Kosovës dhe të Kaçanikut. Në këtë seancë duhej të materializohej Deklarata Kushtetuese e Kosovës e 2 Korrikut 1990, me shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përveç se shpalli Kushtetutën e Republikës, Kuvendi nxori dhe dokumente të tjera përcjellëse, si: ligjin për bashkimin politik dhe bashkimin tjetër të qytetarëve, ligjin për zgjedhjet dhe një numër vendimesh të nevojshme për punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe marrjen e vendimeve në Kuvendin e Jugosllavisë. Bëhej fjalë për një kuvend historik, sepse me Kushtetutën që u shpall atë ditë synohej realizimi i aspiratave të popullit shqiptar, për një kohë të gjatë të ndalura qoftë nga pushteti serb, qoftë nga pushteti jugosllav. Me të kryer seancën, delegatët kërkuan strehim në vende të ndryshme të Europës Perëndimore. Delegatët e Kuvendit të Republikës së Kosovës u ndoqën në udhë joligjore. Neni i Ligjit penal të Jugosllavisë që aplikohet me rastin e ndjekjes së delegatëve (116) bënte fjalë për formë të bashkimit kundër shtetit, edhe pse ata ishin të veshur me imunitet parlamentar,

përderisa ai nuk iu merrej nga Kuvendi. Pas kësaj mbledhjeje, Kuvendi i Kosovës vazhdoi punën në mërgim. Në rrethana të këtylla shumë autorizime i kaluan Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila gjithashtu funksionoi jashtë vendit. Në rrugën e ngritjes së institucioneve të veta të pavarura në shumë fusha të jetës shoqërore, Kosova bazohej në Kushtetutën e Kaçanikut. Qëndrimi i delegatëve të Kuvendit të Kosovës jashtë vendit, shpërndarja e tyre në vende të ndryshme, mungesa e mjeteve financiare dhe pamundësia e koordinimit e bënë shumë të vështirë krijimin e kushteve për seanca të rregullta të Kuvendit, i cili, ndër të tjera, nuk ia doli që ta deklaronte pushtimin e Kosovës nga ana e Serbisë. (Esat Stavileci)

**KUVENDI I KOSOVËS, PRISHTINË (Arki-
tectura).** Ndërtesë e rëndësishë së posaçme administrative, e projektuar gjatë viteve '60 për Këshillin Ekzekutiv Krahinor të Kuvendit



KUVENDI I KOSOVËS

Popullor të Kosovës. Projektues i ndërtesës ishte ark. Juraj Neidhart, me arkitekturë të bazuar në kërkim të stilit kombëtar. Ky projekt, sipas ark. Bashkim Fehmiu, është një paraqitje e gabuar e tipologjisë së objektit administrativ në krahasim me arkitekturën e trendeve moderne të asaj kohe. Për këtë arsye, me kërkesën e arkitektëve vendorë në vitin 1960 bëhet revidimi i projektit dhe rikonstruktimi në pjesën e jashtme të objektit të ndërtuar, duke bërë largimin e kulmeve të pjerrëta dhe duke krijuar kështu arkitekturë moderne, me karakter universal të asaj kohe. Punët e ndërtimit u realizuan në vitin 1969 nga punëkryerësi kryesor, Kombinati ndërtimor "Ramiz Sadiku" nga Prishtina. Sipërfaqja e tërësishme e objektit, pa anekse, ishte rreth 10,200 m², e përbërë nga kulla

pesëkatëshe dhe nga salla e madhe e asamblesë me sipërfaqe prej rreth 1,000 m². Në vitin 1975 punohet projekti për aneksin e parë të Këshillit Ekzekutiv Krahinor, nga EUP Prishtinë, kullë me 15 kate, me sipërfaqe prej 9,200 m², për nevojat e organeve krahinore, por nuk u realizua. Në vitin 1981 bëhet projekti kryesor arkitektonik për garazhe dhe shtypshkronjë, kurse në vitin 1971, sipas planit detal të ish-sheshit "Vëllazërim-Bashkim", ndërtesës së Këshillit Ekzekutiv Krahinor i shtohet aneksi i dytë, i cili lidhet me objektin ekzistues, nga ana e ndërtesës së postës dhe godinës së Sigurimit Social. Ky aneks, sipas kushteve urbane të përcaktuara paraqet objekt në dy pjesë me lartësi të ndryshme, P+2 dhe P+3 dhe tri lamela. Pas luftës së vitit 1999 godina mori statusin e objektit të organit më të lartë, Parlamentit të Kosovës, ku është e vendosur edhe Presidenca. Që atëherë objekti pësoi ndryshime të mëdha, si në brendi, ashtu edhe në pamjen e jashtme, veçmas pas renovimit të vitit 2005. (Vlora Navakazi)

KUVENDI I KROJMIRIT (1920). Kuvend i krerëve të lëvizjes çlirimtare kaçake, nën udhëheqjen e Xhelë Demës, Fazli Beranit dhe Metë Imerit. Çetat e lëvizjes kaçake të Azem Bejtës dhe të Ilaz Reçakut, të cilat kishin mbi 200 veta, vepronin edhe në fshatin Krojmir të Lipjanit, ku kishin një bazë të rëndësishme. Këto çeta u hetuan natën e 25 tetorit të vitit 1920 nga forcat serbe të Rahovecit, të cilat që nga 9 tetori kishin nën vëzhgim çetat kryengritëse shqiptare. Çetat e lëvizjes kaçake, për shkak të situatës së krijuar, vendosën në këtë kuvend të lajmëronin të gjitha çetat, për t'u përgatitur për një luftë të përgjithshme, duke u përforcuar me luftëtarë të rinj. Këtu u vendos që forcat e armatosura nga Drenica të zhvillonin aksione guerile kundër xhandarmërisë dhe forcave të tjera serbe. (SkënderLutfiu).

KUVENDI I MURGULLËS (1920). Kuvend i përgjithshëm i krerëve të lëvizjes kaçake, i mbajtur në fshatin Murgull të Malësisë së Llapit. Kuvendi kishte për qëllim riorganizimin e luftës çlirimtare sipas direktivave të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Kuvendi u organizua pas aksionit të madh e të përgjithshëm të ushtrisë së Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, me qëllim të shuarjes së lëvizjes së rezistencës dhe të spastrimit etnik të Kosovës. Në kuvend

morën pjesë krerët e lëvizjes kaçake nga e gjithë Kosova, si: Azem Bejta, Ferhat Draga, Beqir Rexha, Nak Berisha, përfaqësuesit e Rugovës, Adem Ilazi-Reçaku, çetat e Llapit, Ramë Vllasa, Sahit Repa, Sahit Shajkovci, Tahir Uka, Hoxhë Pollata etj. Kuvendi u siguria nga 800-1,200 kaçakë dhe zgjati 3 ditë. Kuvendi mori vendim që të intensifikohej lufta e çetave në të gjitha territoret e okupuara shqiptare, nga Manastiri e deri në Plavë e Guci, që çetat të viheshin nën një komandë të përgjithshme me komandant Azem Bejtën, të luftohen konfidentët, të propagandohet kundër shpërnguljes për në Turqi etj. Gjithashtu u vendos që gjatë dimrit prijësit e çetave të kalojnë në Shqipëri. Kuvende të ngjashme u mbajtën edhe në disa vende të viseve të pushtuara, si në Drenicë, Rugovë dhe Karadak. Po ashtu një kuvend i ngjashëm u mbajt në mes të Dibrës dhe Kërçovës. (Liman Rushiti).

KUVENDI I PRIZRENIT (8-10 korrik 1945). Sesionin e parë i rregullt i legjislaturës së parë të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, i mbajtur në



MBLEDHJA E KËSHILLIT KRAHINOR TË KOSOVËS DHE METOHISË, NË PRIZREN NË KORRIK TË VITIT 1945

Prizren, që njihet edhe si Kuvendi i Prizrenit. Mbledhja u mbajt më 8-10 korrik të vitit 1945. Sesionin e drejtoi kryetari i Këshillit Popullor Krahinor, Mehmet Hoxha, i cili, mes tjerash, përshëndeti delegatët e Qeverisë së Serbisë, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë të pranishëm në këtë sesion. Raportin e punës të Këshillit Ekzekutiv Krahinor e paraqiti sekretari i tij, Pavle Joviqeviq. Ndërkaq, në emër të Komitetit Nacional të Shqiptarëve foli sekretari i këtij komiteti, Xhavit Nimani, i cili në ditën

e tretë të punës paraqiti edhe raportin për situatën politike në vend. Pas diskutimeve të shumta për situatën politike në Kosovë, edhe përkundër kundërshtimit të disa këshilltarëve shqiptarë, Kuvendi e aprovoi projektin e rezolutës për aneksimin e Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit nga Serbia federale. Me këtë vendim pjesëmarrësit e kësaj mbledhje të Këshillit Popullor të Kosovë-Metohisë, nën tryninë e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, si dhe nën kërcënimin e forcave të armatosura jugosllave hoqën dorë nga Rezoluta e Konferencës së Bujanit. Në këtë kuvend morën pjesë 137 delegatë, përbërja etnike e të cilëve nuk i përgjigjej strukturës etnike të popullsisë së Kosovës (33 ishin shqiptarë, 71 serbë e malazezë, për 33 delegatë nuk ishte dhënë përkatësia kombëtare). Mbështetur në këtë vendim, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë, në mbledhjen e mbajtur më 7-10 gusht 1945 miratoi rezolutën me të cilën territori i Kosovës dhe Metohisë i bashkohej Serbisë federale. Ky kuvend paraqet sendërtimin zyrtar të synimeve të Serbisë për aneksimin e Kosovës. Në mbështetje të këtij vendimi votuan edhe delegatët shqiptarë, të cilët më pas ishin bartësit kryesorë të qeverisjes serbe dhe jugosllave të Kosovës. (Izber Hoti)

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS. Organi më i lartë ligjdhënës i Republikës së Kosovës. Pozita dhe roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës është përcaktuar me Kushtetutën



SEANCË E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e Republikës së Kosovës, e certifikuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar më 2 prill 2008, e miratuar nga Kuvendi më 9 prill 2008, ndërsa hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kuvendi i Republikës së Kosovës është në krye të institucioneve të Kosovës, si organ ligjvënës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar kompetencat e Kuvendit: miratimi i ligjeve, rezolutave dhe akteve të tjera të përgjithshme, si dhe i buxhetit të Kosovës; vendosja për ndryshimin e Kushtetutës me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe 2/3 e votave të të gjithë deputetëve që mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në Kosovë; shpallja e referendumit; ratifikimi i traktateve ndërkombëtare; zgjedhja dhe shkarkimi i kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit; zgjedhja e Qeverisë, me mundësinë e shprehjes së mosbesimit ndaj saj; zgjedhja dhe shkarkimi i presidentit të Republikës; zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës; mbikëqyrja e punës së Qeverisë dhe e institucioneve të tjera publike (të cilat i raportojnë Kuvendit); propozimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës; dhënia e pëlqimit për dekretin e presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe vendosja për çështje me interes të përgjithshëm të përcaktuara me ligj. Nga radhët e veta, Kuvendi zgjedh kryetarin dhe pesë nënkryetarë, që bashkërisht përbëjnë kryesinë e Kuvendit. Tre nënkryetarë propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare, ndërsa dy të tjerët nga komunitetet joshumicë (njëri serb dhe tjetri nga komunitetet e tjera joshumicë). Kuvendi formon tri lloje komisionesh: të përhershme, funksionale dhe ad hoc (për çështje të veçanta). Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka bartur në të dhe tërë legjislacionin me interes vital nga Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ku janë përcaktuar edhe kompetencat e Kuvendit. Ajo pjesë e Kushtetutës përcakton se për miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e një numri të ligjeve kërkohet prej Kuvendit vota e shumicës së deputetëve të pranishëm që mbajnë ulëse të rezervuara ose të garantuara për komunitetet joshumicë. Aty përfshihen ligjet që ndryshojnë kufijtë komunalë, që themelojnë apo shuajnë komunat, ligjet që

zbatojnë të drejtat e komuniteteve, përveç atyre të përcaktuara me Kushtetutë, siç është ligji për përdorimin e gjuhëve, ligji për zgjedhjet lokale, ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ligji për lirinë fetare apo marrëveshjet me bashkësitë fetare, ligji për arsimin, ligji për përdorimin e simboleve, përfshirë dhe ato të komuniteteve dhe ligji për festat publike. Kushtetuta shpreh prerazi se asnjëri nga këto ligje nuk mund të jetë objekt i referendumit. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstitutive, që mbahet brenda 30 ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në rast të gjendjes së jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës dhe vetëm për aq sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme. Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës janë publike. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të mbyllura me kërkesën e presidentit të Republikës së Kosovës, të kryeministrit ose të një të tretës së deputetëve, në rastet e caktuara me rregulloren për punën e Kuvendit. Vendimi miratohet në mënyrë të hapur e transparente dhe kërkon votën e dy të tretave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Kuvendi i Kosovës punimet vjetore i zhvillon në dy sesione. Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, kurse sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të muajit shtator. Kuorumin e Kuvendit e përbën më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit (120). Kuvendi mund të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të presidentit të Republikës, të kryeministrit ose të një të tretës së deputetëve. Kërkohet që përbërja e Kuvendit të Kosovës të respektojë parimet e barazisë gjinore, të cilat janë të pranura në pajtim me parimet ndërkombëtare. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Deputetët e Kuvendit nuk mund të arrestohen dhe të ndalohen, përderisa janë duke kryer detyrat e tyre si deputetë të Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit. (Esat Stavileci)

KUVENDI I VERRAVE TË LLUKËS (1910). Mbledhje e përfaqësuesve të krahinave të vilajetit të Kosovës, kryesisht e pjesës perëndimore e qendrore, ku u hodhën themelet e bashkimit luftarak kundër reaksionit xhonturk. U mbajt nga mesi i prillit të vitit 1910, në vendin e quajtur Verrat e Llukës, në afërsi të Deçanit. Autoritetet xhonturke dhe përkrähësit e tyre, me gjithë përpjekjet që bënë, nuk arritën ta pengonin mbledhjen e këtij Kuvendi. Tubimi u zhvillua nën drejtimin e Shaban Binakut, të Isa Boletinit, të Sulejman Batushës dhe të krerëve të tjerë. Në Kuvend u vendos pajtimi i të gjitha gjaqeve deri në Shën Mitër. Më pas pjesëmarrësit lidhën besën dhe vendosën që të gjitha viset e përfaqësuara prej tyre të bashkoheshin me kryengritjen. U përcaktuan gjithashtu me hollësi masat organizative dhe ushtarake për përballimin e ekspeditës së Shefqet Turgut pashtës. Kuvendi parashikonte edhe masa ndëshkuese për ata që do t'i kundërviheshin besës së lidhur. Tubimi pati rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të kryengritjes së armatosur në Kosovë. (Fitim Rifati)

KUVENDI I VERRAVE TË LLUKËS (1990). Tubim i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve dhe Ngatërresave, i mbajtur më 1 maj 1990 në komunën e Deçanit, në vendin ku ishte mbajtur



TUBIMI POPULLOR I VERRAVE TË LLUKËS, MË 1990

një kuvend i tillë 80 vjet më parë, më 1910. I organizuar nga Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve, Kuvendi i Pajtimin, siç u quajt ndryshe, mori karakterin e manifestimit të unitetit të popullit të Kosovës kundrejt situatës së rëndë politike që kishte kapluar vendin. Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve filloi më 2 shkurt 1990 në fshatin Lumbardh të Deçanit dhe zgjati deri më 17 maj 1992. Shumica e atyre që ideuan Lëvizjen ishin

studentë dhe ish-të burgosur politikë. Lëvizja nisi me moton “t'i nderojmë 32 të vrarët nga terrori shtetëror serb e jugosllav, t'i falim 32 gjaqe, t'i lëmë të paçelura 32 varre të reja”. Aksionit të pajtimit së shpejti iu bashkuan edhe të rinj e studentë të tjerë, profesorë, intelektualë nga e gjithë Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. U shquan në këtë Lëvizje intelektualë si Anton Ceta e Zekeria Cana, pastaj hoxhallarë dhe priftërinj, të cilët përhapnin mesazhin e faljes dhe të pajtimit ndërshqiptar. Në tubimin e Verrave të Llukës morën pjesë rreth gjysmë milioni shqiptarë nga të gjitha viset e Kosovës dhe trojet shqiptare në ish-Jugosllavi. Për nga numri i pajtimeve shënon përmasat e një kuvendi historik gjithëpopullor të pajtimit: U bënë gjithsej 106 pajtime, nga të cilët 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa. Kuvendi i pajtimit u mbajt në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme në Kosovë. Serbia dhe Jugosllavia mobilizuan forca të shumta policore dhe ushtarake për ta mbikëqyrur këtë tubim. Nga strukturat e atëhershme të pushtetit Kuvendi u interpretua si akt i mobilizimit kundër Serbisë dhe Jugosllavisë dhe me këtë pretext u arrestuan dhe u keqtrajtuat shumë pjesëmarrës. (Frashër Demaj)

KUVENDI PËR SUPRIMIMIN E AUTONOMISË SË KOSOVËS (1990). Mbledhja e Kuvendit të Serbisë e 26 qershorit 1990, në të cilin u nxor vendimi kundërkushtetues për aplikimin e rrethanave të posaçme në Kosovë. Ky vendim u nxor nën ndikimin e vlerësimeve politike të kreut politik serb dhe jugosllav mbi gjoja “rrezikimin e rendit kushtetues në Kosovë”. Si bazë për marrjen e këtij vendimi merrej, siç thuhej nga pushteti serb, “ndërmarrja e aktiviteteve të orientuara për rrënimin e rendit të vendosur me Kushtetutë dhe të tërësisë territoriale”. Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtij vendimi ishte shkatërrimi i sistemit kushtetues të Kosovës dhe krijimi i kushteve që Serbia, duke i shpallur rrethanat e posaçme në Kosovë (në kundërshtim me Kushtetutën Federative në fuqi), të merrte autorizimet e organeve krahinore dhe ato t'i bartte në organet e saj republikane. (Arsim Bajrami)

KYLÇE Sylejman (Süleyman Külçe) (1884-1955). Ushtarak, historian. Pas përfundimit të shkollës ushtarake, u emërua në pozita të ndryshme ushtarake në territorin e Perandorisë

Osmane. Më 1908 emërohet sekretar personal i komandantit të Mitrovicës, Ferik Shemsi pashës, i cili konsiderohej si njëri ndër personalitetet e afërta të Sulltan Abdylhamitit II. Më pas shërbeu në zona të ndryshme shqiptare, me çrast mbledhi shënime me rendësi për viset kufitare të Kosovës me Serbinë dhe Malin e Zi. Pas përfundimit të karrierës ushtarake, u vendos në qytetin e Izmirit të Turqisë, ku punoi në zyrën e financave. Shënimet e mbajtura

i botoi më vonë si vepra të veçanta, siç janë: “Shqipëria në Historinë Osmane” (Osmanlı Tarihinde Arnavutluk, 1944); “Kuvendi i Ferizajt dhe Kushtetuta” (Ferizovik Toplantısı ve Meşrutiyet, 1944); “Jeta dhe veprimtaria e mareshalit Fevzi Çakmak” (Marşal Fevzi Çakmak: Askeri, Siyasi, Hususi Hayatı, 1946) etj. Në këto dhe vepra të tjera hidhet dritë për ngjarje të rëndësishme të historisë së Kosovës dhe viseve të tjera të Ballkanit. (Agron Islami)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
FJALORI ENCIKLOPEDIK I KOSOVËS

Prishtinë, 2018

Dizajni grafik dhe faqosja: Samir Haliti & Agon Çeta

Lektorë: Bahri Koskoviku, Shefqet Riza

Shtypi: Focus-Print, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

030(=18)

Fjalori enciklopedik i Kosovës / kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës Mehmet Kraja. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018. – libra: ilustr.; 26 cm.

[Vëllimi] I: A-K. – VIII, 935 f.

1.Kraja, Mehmet

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze.

ISBN 978-9951-615-84-6

ISBN 978-9951-615-85-3

ISBN 978-9951-615-85-3



9 789951 615853